UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI JURIDIK

Enver HASANI
Muhamet BRAHIMI

GJYQËSIA KUSHTETUESE

Prishtinë, 2021

Enver Hasani
Muhamet Brahimi

Gjyqësia Kushtetuese

Prishtinë, 2021

Recensentë:

Prof. dr. Faik Brestovci
Prof. dr. Hajredin Kuçi
Prof. dr. Iliriana Islami

Dizajni dhe Shtypi:

NTG "Blendi", Prishtinë

Këshilli Botues i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” lejoi botimin dhe përdorimin e këtij teksti me Vendimin nr. 1/437, datë 23.06.2020.

© 2021, autorët dhe botuesit ruajnë të gjitha të drejtat.

Ky libër iu kushtohet personave me sindromën Down në Republikën e Kosovës.

PËRMBAJTJA

FALËNDERIME xiii
SHKURTESAT xv
1. HYRJE 21
1.1. Kuptimi i gjyqësisë kushtetuese 21
1.2. Dallimi i gjyqësisë kushtetuese nga format tjera të dhënies së drejtësisë 24
1.3. Vendi i gjyqësisë kushtetuese në sistemin nacional të drejtësisë 27
1.4. Plani i librit 28
1.5. Komente dhe pyetje 29
1.6. Lexim shtesë 30

PJESA E PARË 31
ASPEKTE FILOZOFIKE-TEORIKE MBI ORIGJINËN, ZHVILLIMN DHE KONTEKSTIN SHOQËROR TË LINDJES SË KONTROLLIT KUSHTETUES NËPËR VENDE E SISTEME TË NDRYSHME, ME VËSHTRIM TË VEÇANTË NË BOTËN EURO-ATLANTIKE

2. ORIGJINA: ASPEKTE FILOZOFIKE-TEORIKE DHE KONTEKSTI SHOQËROR 33
2.1. Botëkuptimet mbi një rend superior, më të lartë: bota antike deri te kushtetutat e para të shkruara 34
2.2. Revolucioni Francez dhe kontrolli kushtetues 40
2.3. Pavarësia e SHBA-së dhe kontrolli gjyqësor 44
2.4. Përhapja e kontrollit gjyqësor në Evropë dhe përtej 47
2.5. Komente dhe pyetje 50
2.6. Lexim shtesë 51

3. KONTEKSTI DHE ARSYETIMI TEORIK I LINDJES DHE ZHVILLIMIT TË GJYQËSISË KUSHTETUESE 53
3.1. Shekujt formativë të gjyqësisë kushtetuese: fundi shekullit XVIII deri te mbarimi i Luftës e Dytë Botërore (Evropa, Amerika Latine dhe vendet arabe) 54
3.2. Periudha në mes të dy luftërave botërore: debati Kelsen – Shmit 65
3.3. Periudha pas Luftës së Dytë Botërore: Tri fazat e zhvillimit 72
3.4. Rënia e komunizmit dhe zhvillimet në gjyqësinë kushtetuese 77
3.5. Komente dhe pyetje 79
3.6. Lexim shtesë 81

4. SISTEMET (I): DEMOKRACITË LIBERALE 83
4.1. Sistemi amerikan 83
4.2. Sistemi evropian/kelsenian 87
4.3. Sistemi i përzier apo hibrid 89
4.4. Vendet nordike 95
4.5. Komente dhe pyetje 102
4.6. Lexim shtesë 104

5. SISTEMET (II): VENDET ISH-KOMUNISTE, DJE DHE SOT 105
5.1. Jugosllavia 106
5.2. Hungaria, Polonia dhe Çekosllovakia 124

5.3. Vendet tjera 133
5.4. Komente dhe pyetje 157
5.5. Lexim shtesë 159
6. SISTEMET (III): VENDET E AMERIKËS LATINE DHE KARAIBET 161
6.1. Modeli difuz (i decentralizuar) i ndikuar nga SHBA-të 166
6.2. Modeli i koncentruar (centralizuar) pa gjykatë të ndarë kushtetuese 172
6.3. Modeli i koncentruar (i centralizuar) me gjykatë të ndarë kushtetuese 181
6.4. Sistemet tjera të kontrollit kushtetues 185
6.5. Komente dhe pyetje 187
6.6. Lexim shtesë 190

7. SISTEMET (IV): VENDET ISLAMIKE 191
7.1. Arabia Saudite dhe Egjipti 194
7.2. Egjipti 197
7.3. Irani 200
7.4. Vendet e Magrebit: Algjeria, Maroku dhe Tunizia 204
7.5. Komente dhe pyetje 214
7.6. Lexim shtesë 217

8. SISTEMET TJERA (V): VENDET E CAKTUARA TË AZISË DHE AFRIKËS 219
8.1. Turqia 222
8.2. Izraeli 229
8.3. Vendet e Azisë Qendrore (Azerbajxhani, Kazakistani, Kirgistani, Taxhikistani, Uzbekistani) ...238
8.4. Vendet e Azisë Juglindore: Indonezia 248
8.5. Vendet e Azisë Juglindore: Koreja e Jugut 251
8.6. Vendet e Azisë Juglindore: Malejzia 253
8.7. Mongolia 255
8.8. Vendet tjera aziatike: Kina, Tajvani dhe Japonia 258
8.9. Afrika: Afrika e Jugut dhe vendet tjera afrikane 270
8.10. Komente dhe pyetje 278
8.11. Lexim shtesë 283

9. KOMISIONI I VENECIAS: KRIJIMI, QËLLIMET DHE RËNDËSIA E TIJ 285
9.1. Institucionet demokratike dhe të drejtat e njeriut 287
9.2. Gjyqësia kushtetuese dhe gjyqësia e rregullt 289
9.3. Zgjedhjet, referendumet dhe partitë politike 293
9.4. Komente dhe pyetje 296
9.5. Lexim shtesë 298

PJESA E DYTË 299
GJYQËSIA KUSHTETUESE NË KOSOVË DERI NË FITIMIN E PAVARËSISË DHE PAS SAJ

10. DERI NË FITIMIN E PAVARËSISË 301
10.1. Periudha deri në nxjerrjen e Kushtetutës së vitit 1974 307
10.2. Periudha pas vitit 1974, ardhja në pushtet të diktatorit serb Slobodan Milosheviq dhe ndërhyrja ushtarake e NATO-së për të ndihmuar çlirimin e Kosovës 319
10.3. Periudha nën administrimin ndërkombëtar deri te shpallja e pavarësisë 338
10.4. Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe dizajni kushtetues aktual 361
10.5. Komente dhe pyetje 373
10. 6. Lexim shtesë 377
11. PAS FITIMIT TË PAVARËSISË 379

11.1. Cilësitë themelore të fizionomisë së Gjykatës Kushtetuese dhe specifikat e saj 387
11.2. Juridiksioni i kufizuar i Gjykatës Kushtetuese (gjatë pavarësisë së ur dhe pas themelimit të Gjykatës Speciale) 405
11.3. Juridiksioni aktual i Gjykatës Kushtetuese 414
11.3. 1. Juridiksioni nga neni 113. 1 i Kushtetutës 420
11. 3. 2. Juridiksioni nga neni 113. 2 (pikat 1 dhe 2) i Kushtetutës 421
11. 3. 3. Juridiksioni nga neni 113. 3 (pikat 1 deri 5) i Kushtetutës 426
11. 3. 4. Juridiksioni nga neni 113. 4 i Kushtetutës 440
11. 3. 5. Juridiksioni nga neni 113. 5 i Kushtetutës 443
11. 3. 6. Juridiksioni nga neni 113. 6 i Kushtetutës 446
11.3.7. Juridiksioni nga neni 113. 7 i Kushtetutës si një juridiksion konkret dhe derivativ në lëmin e lirive dhe të drejtave kushtetuese: ankesa kushtetuese 449
11.3.8. Juridiksioni nga neni 113.8 i Kushtetutës si juridiksion konkret derivativ në lëmin e kontrollit incidental të kushtetutshmërisë 456
11.3.9. Juridiksioni nga neni 113.9 i Kushtetutës si realizim i doktrinës kosovare mbi amendamentet kushtetuese antikushtetuese 461
11.3.10. Juridiksioni shtesë i përcaktuar me ligj 476
11.4. Komente dhe pyetje 478
11. 5. Lexim shtesë 483

12. CAKTIMI I GJYQTARËVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE DHE STATUSI I TYRE..485
12.1. Zgjedhja gjatë kohës së pavarësisë së mbikëqyrur 486
12.2. Zgjedhja pas përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur 508
12.3. Statusi 518
12.3.1. Papajtueshmëria 519
12.3.2. Privilegjet (rroga, mëditjet, protokolli, makina, banesa etj) 526
12.3.3. Imunitetet dhe shkarkimi 531
12.4. Komente dhe pyetje 564
12.5. Lexim shtesë 567

13. *STARE DECISIS* SI DETYRIM KUSHTETUES I AUTORITETEVE PUBLIKE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS 569
13. 1. Kuptimi, lindja dhe zhvillimi i stare decisis 571
13.2. Statusi kushtetues i të drejtës ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut 583
13.3. Statusi kushtetues i *stare decisis* i GJEDNJ në praktikën e Gjykatës Kushtetuese 587
13.3.1. Caqet e *stare decisis* në procedurën e caktimit të masave të përkohshme 599
13.3.2. Caqet e *stare decisis* në pranueshmërinë e kërkesës 607
13.3.3. Caqet e *stare decisis* në meritat e rastit 609
13.4. Komente dhe pyetje 611
13.5. Lexim shtesë 615

14. AKTIVIZMI GJYQËSOR SI MODUS OPERANDI DHE ÇËSHTJE TË TJERA 617
14.1. Kuptimi i zakonshëm i aktivizmit gjyqësor 622
14.2. Dizajni institucional dhe faktorët ambientalë (rrethanorë) si shkaqe të aktivizmit gjyqësor 625
14.3. Aktivizmi në sferën e kompetencës procedurale 657
14.4. Teknikat e interpretimit që ndihmojnë aktivizmin gjyqësor 664
14.5. Vetëpërmbajtja gjyqësore 671
14.6. Kultura juridiko-politike në Kosovë si shkak i keqkuptimeve lidhur me rëndësinë dhe rolin e aktivizmit gjyqësor në kohë tranzicioni 678
14.7. Komente dhe pyetje 700
14.8. Lexim shtesë 708

15. EFEKTET, NATYRA JURIDIKE DHE ZBATIMI I VENDIMEVE TË GJYKATAVE KUSHTETUESE 709
15. 1. Sqarime paraprake: *Erga Omnes* si efekt i përgjithshëm, *Inter Partes* si efekt i kufizuar dhe dallimet e tyre me *Res Judictata* si efekt specifik i vendimit 710
15.2. Llojet e vendimeve për nga natyra juridike dhe efektet që prodhojnë 727
15.2.1. Vendimet që nuk gjejnë shkelje kushtetuese 728
15. 2. 2. Vendimet që gjejnë shkelje kushtetuese dhe modalitetet e menaxhimit të pasojave juridike të gjetjeve të tilla 737
15. 2. 2. 1. Gjetja e shkeljes së normave dhe parimeve kushtetuese me pasojë anulimin e normës/ligjit të sfiduar dhe modalitetet e tjera për ndreqjen e jokushtetutshmërisë së gjetur 738
15. 2. 2. 2. Gjetja e shkeljes së normave apo parimeve kushtetuese me pasojë anulimin e normës së sfiduar (apo të ligjit si tërësi), jo me efekt imediat, por duke shtyrë anulimin 744
15. 2. 2. 3. Gjetja e shkeljes së normave dhe parimeve kushtetuese, pa pasur për pasojë anulimin e normës së sfiduar (apo ligjit si tërësi) 748
15. 3. Struktura dhe llojet e argumentit kushtetues 752
15.4. Zbatimi i vendimeve të gjykatave kushtetuese 773
15.5. Komente dhe pyetje 780
15.6. Lexim shtesë 787

16. MBI VENDIMET KRYESORE TË GJYKATËS KUSHTETUESE NË DEKADËN E PARË 789
16.1. Rasti i RTK 793
16.2. Tregimi për dy Presidentët 794
16.3. Rasti Jahjaga 800
16.4. Rasti AKP 802
16.5. Rasti VLAN 805
16.6. Rasti "Banka Raiffeisen" 810
16.7. Rasti Asociacionit Serb 818
16.7.1. Rrethanat e krijimit të rastit 820
16.7.2. Vendi i marrëveshjeve ndërkombëtare në rendin e brendshëm 822
16.7.3. Kontrolli kushtetues i marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga parlamenti 825
16.7.4. Kontrolli kushtetues i marrëveshjeve të paratifikuara ndërkombëtare 828
16.8. Rasti Manastirit të Deçanit 833
16.9. Rasti zgjedhjes së Presidentit Thaçi 835
16.10. Rasti KQZ 837
16.11. Rasti i tentim-rrënimit të Gjykatës Speciale 843
16.12. Rasti "përsëritja e procedurës" 845
16.12.1. Aspektet problematike të natyrës kushtetuese në vendimet që lidhen me përsëritjen e procedurës 848
16.12.2.1. *Raison d' etre* e nenit 53 të Kushtetutës 849
16.12.2.2. Katër rastet e vendosura nga Gjykata Kushtetuese 853
16.12.2.3. Rasti parë: *Rasti KI 159/15* 855
16.12.2.4. Rasti i dytë: Rastet KI 80/15, KI 81/15 dhe KI 82/15 (të bashkuara) 856
16.12.2.5. Rasti tretë: Rasti KI 07/17 857
16.12.2.6. Rasti i katërt: *Rasti KI 40/19* 859
16.13. Standardet e Strasburgut në rastet e përsëritjes së procedurës 860
16.13.1. Precedenti i parë: *Zawadzki kundër Polonisë* (dec), nr. 34158/96, 6 korrik 1999 860
16.13.2. Precedenti i dytë: *Sablon kundër Belgjikës,* kërkesa nr. 36445/97, § 86, 10 prill 1997 862
16.13.3. Precedenti i tretë: *Steck-Risch dhe të tjerët kundër Lihtenshtajnit* (dec), nr. 29061/08, 11 maj 2010 864
16.13.4. Precedenti i katërt: *Nistler kundër Austrisë,* nr. 24912/08, Vendim i 19 nëntorit 2013 869

16.13.5. Precedenti pestë: *Dichev kundër Bullgarisë,* nr. 1355/04, Aktgjykim i 27 janarit 2011..... 871
16.13.6. Precedenti gjashtë: *Oberschlick kundër Austrisë,* nr. 23727/94, Aktvendim për papranueshmëri i 21 marsit 1994 873
16.13.7. Precedenti shtatë: *Dowsett kundër Mbretërisë së Bashkuar,* nr. 8559/08, Aktvendim për papranueshmëri i 4 janarit 2011..... 875
16.13.8. Precedenti i tetë: *Franz Fischer kundër Austrisë* nr. 27569/02, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 majit 2003)..... 877
16.14.9. Përsëritja e procedurës si institut dhe mjet juridik efektiv në botën bashkëkohore, në Kosovë *Quo Vadis*? 878
16.15. Komente dhe Pyetje 881
16.16**.** Lexim shtesë 887

LITERATURA 889
A. Libra..... 889
B. Artikuj..... 901
C. Akte juridike..... 928
D. Materiale të tjera..... 935
Treguesi..... 958
Shënime për autorët..... 993

FALËNDERIME

Ata që duhen falënderuar për shkak të mbështetjes së nduarnduarshme që na kanë ofruar gjatë prodhimit të këtij libri janë të shumtë, për të mos thënë që lista e tyre gati fund nuk ka. Ne, megjithatë, kemi vendosur të falënderojmë këtu në këtë hapësirë të ngushtë e të shkurtër vetëm ata që na ndihmuan aq shumë sa kontributi i tyre, lirisht mund të thuhet, shkrihet me tonin dhe bëhet një. U mor vesh, krejt lëshimet dhe çdo gjë tjetër që ka të bëjë me anën profesionale të tekstit, janë tonat dhe të askujt tjetër.

Të tjerëve që nuk arritëm t'i falënderojmë me emër dhe kanë dhënë kontribut që ky libër të sheh dritën, iu kërkojmë falje dhe i falënderojmë nga thellësia e zemrës.

Falënderimin e nisim me bashkëshortët tona, **Burbuqen** dhe **Nerxhivanin** respektivisht, dhe me familjet tona që patën aq shumë konsideratë dhe na duruan tërë këto pesë vjet sa punuam në libër. Iu kemi munguar atyre, ata neve më shumë, kemi humbur ngrohtësinë reciproke të jetës në familje për shkak se prodhimi i librit ka kërkuar net të tëra pa gjumë, sakrificë dhe përpjekje titanike për t'i dalë në fund. E kryem, më në fund! E nisëm në qershor të vitit 2015 dhe e mbyllëm në kohën e pandemisë **COVID-19**, në tetor të vitit 2020.

Profesorit **Fazil Hajrizi** nga **Mitrovica**, intelektualit erudit dhe njeriut që ka lënë prapa aq shumë vepra për historinë e qytetit të Mitrovicës, në veçanti për personalitetet më me nam të historisë sonë kombëtare me origjinë nga ky qytet, por edhe për historinë e arsimit shqip aty, i jemi posaçërisht mirënjohës dhe falënderues pafund që pati mirësinë për të lexuar dorëshkrimin dhe për t'i bërë korrigjimet e duhura gjuhësore. Hiç më pak mirënjohës i jemi **Azem Deliut**, një shkrimtari të ri e të devotshëm dhe një dashamiri të madh të njerëzve të letrave dhe librit shqip, për shkak se me zell dhe kujdes të shtuar ndihmoi në saktësimin e shprehjeve dhe kuptimeve shqip të përdorura në këtë libër.

Nga komuniteti i juristëve, na duhet të veçojmë kontributin shumë të madh që kanë dhënë për prodhimin e këtij libri, kolegët **Përparim Gruda** e **Zahir Çerkini**, të cilët kanë lexuar secilin kapitull nga dy herë dhe janë kujdesur që mos të lihet pa vërejtur e përmirësuar asnjë gabim. Ua kam pasur lakmi për durimin dhe konsistencën gjatë rileximit dhe korrigjimit të gabimeve krejt të imëta, punë që mund ta kryejnë vetëm njerëzit e tillë të përkushtuar ndaj profesionit të juristit.

Për të gjithë këta persona, si edhe për ata që nuk na mjafton hapësira t'i përmendim këtu, vlen thënia e njohur e shkrimtares, aktivistes dhe ligjëruese së famshme amerikane, **Helen Keller**, e cila famërisht pati thënë: Më me qejf do të ecja me një shok nëpër errësirë, sesa vetëm nëpër dritë.

Libri i kushtohet personave të prekur me sindromin **DOWN**, të cilëve u takojnë të gjitha fitimet nga shitja e tij.

Prishtinë, dhjetor 2020

Prof. Dr. Enver Hasani

Muhamet Brahimi

SHKURTESAT

AAK: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
AKM: Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit
AKS: Asociacioni i Komunave Serbe
AP e KE : Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës
AP e OKB : Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara
APN: Asambleja Popullore Nacionale e Algjerisë
AKP : Agjensioni Kosovar i Privatizimit
Asambleja : Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës
BB: Banka Botërore
BE: Bashkimi Evropian
BRSS: Bashkimi i Republikave Sovjetike Socialiste
Buletini: Buletini i Praktikës Gjyqësore Kushtetuese i Komisionit të Venecias
CODICES: Banka e të dhënave e Komisionit të Venecias
CHP: "Cumhuryet Halk Partisi", parti politike në Turqi
Common Law : E drejta e përgjithshme, e ndryshme nga e drejta civile (kontinentale)
Dega e Posaçme: Dega e Posaçme Kushtetuese pranë Gjykatës së Lartë të KSAK, që ka ekzistuar nga vitti 1969 deri në vitin 1972 kur është themeluar Gjykata Kushtetuese e KSAK
DP: "Demokratik Partisi", parti turke në Turqi
DUDNJ : Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
DHKGJSKir: Dhoma Kushtetuese e Gjykatës Supreme të Kazakistanit
DHKGJSKir: Dhoma Kushtetuese e Gjykatës Supreme të Kirgistanit
DHKM: Dhoma Kushtetuese në kuadër të Gjykatës Supreme të Marokut
EULEX: Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
FMN: Fondi Monetar Ndërkombëtar
FRAQ: Federata e Republikës së Amerikës Qendrore
GDN: Grupi Drejtues Ndërkombëtar që ka ekzistuar gjatë pavarësisë së mbikëqyrur të Kosovës
Grundnorm: Normë bazike
GJDKA: Gjykata e Drejtësisë së Karaibeve
GJED: Gjykata Evropiane e Drejtësisë
GJEDNJ: Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut apo Gjykata e Strasburgut
GJFM: Gjykata Federale e Malajzisë
GJFSHP: Gjykata Federale e Sheriatit në Pakistan
GJKAr: Gjykata Kushtetuese e Armenisë
GJKAJ: Gjykata Kushtetuese e Afrikës së Jugut
GJKAu : Gjykata Kushtetuese e Austrisë
GJKAz: Gjykata Kushtetuese e Azerbajxhanit
GJKBj: Gjykata Kushtetuese e Bjellorusisë
GJKBu: Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë

GJKÇe : Gjykata Kushtetuese e Çekisë

GJKÇK: Gjykata Kushtetuese e Çekosllovakisë

GJKFr: Gjykata e Kasacionit në Francë

GJKFR: Gjykata Kushtetuese e Federatës së Rusisë

GJKFSSR: Gjykata Kushtetuese e Federatës Sovjetike Socialiste të Rusisë

GJKIn: Gjykata Kushtetuese e Indonezisë

GJKMon: Gjykata Kushtetuese e Mongolisë

GJKKSAK: Gjykata Kushtetuese e Kosovës ish-komuniste, e rrënuar nga regjimi i Millosheviqit në mars të vitit 1989

GJKRS/Gjykata Kushtetuese/Gjykata: Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës e formuar pas shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt 2008

GJND: Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë

Gjykata Speciale: Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar, të formuara në gusht të vitit 2015

GJLA: Gjykata e Lartë e Australisë

GJLDIz: Gjykata e Lartë e Drejtësisë më Izrael

GJSJa: Gjykata Supreme e Japonisë

GJSK: Gjykata Supreme e Kosovës

GJKKir: Gjykata Kushtetuese e Kirgistant

GJKKJu: Gjykata Kushtetuese e Koresë së Jugut

GJSDE: Gjykata Supreme e Drejtësisë në El Salvador

GJSDH: Gjykata Supreme e Drejtësisë në Honduras

GJSKIt: Gjykata Supreme e Kasacionit në Itali

GJSKJu: Gjykata Supreme e Koresë së Jugut

GJSDK: Gjykata Supreme e Drejtësisë në Kostarikë

GJSDM: Gjykata Supreme e Drejtësisë në Meksikë

GJSDN: Gjykata Supreme e Drejtësisë në Nikaragua

GJSDP: Gjykata Supreme e Drejtësisë në Panama

GJSDPG: Gjykata Supreme e Drejtësisë në Paragvaj

GJSDU: Gjykata Supreme e Drejtësisë në Urugvaj

GJKHu: Gjykata Kushtetuese e Hungarisë

GJKIt: Gjykata Kushtetuese e Italisë

GJKG: Gjykata e Kushtetutshmërisë e Guatemalës

GJKGJe ose **GJKGje**: Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë

GJKasR: Gjykata e Kasacionit e Rumanisë

GJKKO: Gjykata Kushtetuese e Kolumbisë

GJKKr : Gjykata Kushtetuese e Kroacisë

GJKM: Gjykata Kushtetuese të Marokut

GJKMol: Gjykata Kushtetuese e Moldavisë

GJKMV: Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë së Veriut

GJKRFJ: Gjykata Kushtetuese e Republikës Federale të Jugosllavisë, e themeluar nga diktatori serb Sllobodan Milosheviq në pranverë të vitit 1992, pas shpërbërjes së tërësishme të ish-Jugosllavisë

GJKRSFJ ose **GJKJu :** Gjykata Kuhstetuese e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (1963-1992)
GJKRu: Gjykata Kushtetuese e Rumanisë
GJKSrb ose **GJKS**: Gjykata Kushtetuese e Serbisë
GJKSlk: Gjykata Kushtetuese e Sllovakisë
GJKSp: Gjykata Kushtetuese e Spanjës
GJKSU: Gjykata Kushtetuese e Surinamit
GJKSH: Gjykata Kushtetuese e Republikë së Shqipërisë
GJKTa: Gjykata Kushtetuese e Taxhekistanit
GJKTajv: Gjykata Kushtetuese e Tajvanit
GJKTr: Gjykata Kushtetuese e Turqisë
GJKTZ: Gykata Kushtetuese e Tunizisë
GJKUk : Gjykata Kushtetuese e Ukrainës
GJKUz: Gjykata Kushtetuese e Uzbekistanit
GJLD: Gjykata e Lartë e Danimarkës
GJSBM: Gjykata Supreme e Britanisë së Madhe
GJSDA : Gjykata Supreme e Drejtësisë në Argjentinë
GJSDK: Gjykata Supreme e Drejtësisë e Kilit
GJSDKO ose GJSDK: Gjykata Supreme e Drejtësisë në Kolumbi
GJSDV: Gjykata Supreme e Drejtësisë në Venezuelë
GJSG: Gjykata Supreme e Greqisë
GJSEst: Gjykata Supreme e Estonisë
GJSSHBA ose **GJSAm**: Gjykata Supreme e SHBA
GJSIn: Gjykata Supreme e Indonezisë
GJSIr: Gjykatës Supreme e Irlandës
GJSIra: Gjykata Supreme e Iranit
GJSIz: Gjykata Supreme e Izraelit
GJSJa: Gjykata Supreme e Japonisë
GJSKa: Gjykata Supreme e Kanadasë
GJSKE: Gjykata Supreme Kushtetuese e Egjiptit
GJSKu: Gjykata Supreme e Kubës
GJSNo: Gjykata Supreme e Norvegjisë
GJSPa: Gjykata Supreme e Pakistanit
GJSPO: Gjykata Supreme e Portugalisë
GJSRPK: Gjykata Supreme e Republikës Popullore të Kinës
GJTHDKR: Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda
IPVQ: Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë
KAÇKJ: Këshilli Anitifashist i Çlirimit Kombëtar të Jugosllavisë
KAu: Kushtetuta e Austrisë
KE: Këshilli i Evropës
KEDNJ: Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KFOR: Forca Ndërkombëtare Ushtarake në Kosovë, e përbërë nga trupat e vendeve të NATO-s

KEK: Korportata Energjike e Kosovës
Këshilli i Përbashkët: Këshilli i Përbashkët i Gjyqësisë Kushtetuese i Komisionit të Venecias
KGJM: Këshilli i Gjyqtarëve e të Mëdhenj (Tajvan)
KKA: Këshilli Kushtetues Algjerian
KKKaz: Këshilli Kushtetues i Kazakistanit
KKM: Këshilli Kushtetues i Marokut
KKT: Këshilli Kushtetues i Tunizisë
Komiteti: Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës
Komisioni i Venecias: Komisioni Evropian për Demokraci Përmes Ligjit
KNDCP : Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike
Kongresi: Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Regjionale i KE
KPK: Këshilli Prokurorial i Kosovës
KQZ: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KSAK : Krahina Socialiste Autonome e Kosovës
KS i OKB: Këshilli i Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara
KSHFr: Këshilli Shtetëror i Francës
KV : Kushtetuta e Vajmarit
KVTD: Konventa e Vjenës për të Drejtën e Traktateve
LDK: Lidhja Demokratike të Kosovës
Ligji nr. 03/L-121: Ligji nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës
LTKS: Ligji Organik mbi Tribnunalin Kushtetues të Spanjës
LVV: Lëvizja Vetëvendosje
LVV : Lëvizja Vetëvendosje
LZP: Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës
Mbretëria Jugosllave: Emëri zyrtar i ish-Jugosllavisë nga viti 1929 deri në vitin 1943
Mbretëria SKS: Mbretëria Serbo-Kroato-Sllovene, emëri zyrtar i ish-Jugosllavisë nga viti 1918 deri në vitin 1929
Memorandumi: Memorandumi i Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve (ASSHA)
MNB: Ministria e Ndërtimit dhe Banimit (Izrael)
NATO: North Atlantic Trearty Organization apo Organiztata e Traktatit të Atlantikut Verior
NISMA: Nisma për Kosovën
OLAF: "The European Anti-Fraud Office"
OSBE: Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OSBE/ODIHR: Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PDK: Partia Demokratike e Kosovës
PCN: Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar
PKJ: Partia Komuniste e Jugosllavisë
PKK: Partia Komuniste të Kinës
PLANI AHITISARI: *Propozimi* Gjithëpërfshirës *për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës i vitit 2007, mbi bazën e të cilit* ***është*** *shpallur pavarësia e Kosovës më 17 shkurt 2008*
PSSP: Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm

PZAP: Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

QPC: K*ërkesa për kontroll prioritar të kushtetutshmërisë së ligjit*

Reichsgericht : Gjykata Supreme e Rajhut (1879-1945)

RFDJ: Republika Federale Demokratike e Jugosllavisë, emëri zyrtar i ish-Jugosllavisë nga viti 1943 deri në vitin 1946

RFJ (Serbia dhe Mali i Zi): Emëri zyrtar i njërit prej 5 shteteve të dala nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë në pranverë të vitit 1992, i krijuar nga diktatori serb S. Millosheviq në prill të vitit 1992

RSFJ: Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, emëri zyrtar i ish-Jugosllavisë nga viti 1963 deri në shpërbërjen e saj totale në pranverë të vititi 199

RP : Rregullat e Procedurës së GJKRKS

RP: Rregullat e Procedurës

RTK: Radio Televizioni i Kosovës

SHBA: Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Staatsgerichtshof : Gjykata Shtetërore e Rajhut, e themeluar me KV

TGK : Tribunali i Garnacioneve Kushtetuese i Spanjës, i themeluar sipas Kushtetutës së Spanjës të vitit 1931

TGKE: Tribunali i Garancioneve Kushtetuese i Ekvadorit

TGKP: Tribunali i Garancioneve Kushtetutese i Perusë

TK: Tribunali i Kasacionit, i themeluar në Francë vitin 1790

TKK: Tribunali Kushtetues i Kilit

TMK: Trupat Mbrojtëse të Kosovës

TKB: Tribunali Kushtetues i Bolivisë

TKPB: Tribunali Kushtetues Plurinacional i Bolivisë

TKPo: Tribunali Kushtetues i Portugalisë

TKPol: Tribunali Kushtetues Polak

TSB: Tribunali Suprem i Brazilit

TSDV : Tribunali Suprem i Drejtësisë në Venezuelë

TSDV : Tribunali Suprem i Drejtësisë në Venezuelë

TSFB: Tribunalit Suprem Federal në Brazil

TKSp: Tribunali Kushtetues i Spanjës

UÇK: Ushtria Çlirimtare e Kosovës

UNMIK: Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, i themeluar në bazë të Rezolutës së KS të OKB 1244 të datës 10 qershor 1999

USMZ: Unioni Serbi – Mali Zi, emri zyrtar i RFJ pas Marrëveshjes së Beogradit, e lidhur më 2003 në mes të Serbisë dhe Malit të Zi për ndryshimin e emërtimit të RFJ dhe krijimin e Unionit. U shpërbë në qershor të vitit 2006 kur Mali i Zi shpalli pavarësinë e plotë nga USMZ

VLAN: Koalicioni i partive politike “Lëvizja Vetëvendosje”, “Lidhja Demokratike e Kosovës”, “Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës” dhe “NISMA për Kosovën”

VOTA: Banka e të dhënave e Komisionit të Venecias në lëmin e zgjedhjeve

1. HYRJE

1.1. Kuptimi i gjyqësisë kushtetuese

Gjyqësia kushtetuese është aktivitet i specializuar institucional në lëmin e të drejtës publike. Ky aktivitet zakonisht kryhet nga organet e specializuara të sistemit të drejtësisë në një vend, të cilat quhen gjykata kushtetuese apo gjykata të kompetencës së përgjithshme. Këto të fundit, në kuadër të kompetencave të përgjithshme kanë edhe zgjidhjen e çështjeve kushtetuese.

Si aktivitet që zhvillohet nga gjykatat kushtetuese, si organe të specializuara në dhënien e drejtësisë kushtetuese, gjyqësia kushtetuese ka filluar të cilësohet nga vitet tridhjetë të shekullit njëzet. Gjyqësia kushtetuese aktualisht paraqet sinonim për drejtësinë kushtetuese që kryhet nga ana e gjykatave të ndara nga sistemi i gjyqësorit të rregullt, ani se fillimisht ajo ka lindur dhe është zhvilluar në gjirin e gjyqësorit të rregullt si një aktivitet rutinor lidhur me interpretimin e kushtetutës me rastin e dhënies së drejtësisë së zakonshme në çështjet penale, civile dhe administrative. Në këtë kuptim gjyqësia kushtetuese ka filluar për herë të parë në **Angli** më 1610 (rasti **Dr. Bonham**) për t'u përsëritur si praktikë në **SHBA** dyqind vjet më vonë në rastin e njohur si **Marbury v. Madison** (1803). Ky rast, siç do flasim më vonë, i ka dhënë vulën kontrollit kushtetues siç e njohim sot, ani se filloi në kuadër të gjyqësorit të rregullt gjatë ushtrimit të kompetencave të tij të përgjithshme.

Si në rastin e parë, kur gjyqësia kushtetuese jepet nga një organ i ndarë dhe i specializuar me kompetencë të posaçme në lëmin e drejtësisë kushtetuese, ashtu dhe në rastin e dytë, kur kjo jepet në kuadër të aktivitetit të përgjithshëm të gjyqësorit të rregullt, gjyqësia kushtetuese nënkupton një aktivitet specifik të dhënies së drejtësisë në një shoqëri të organizuar në shtet. Ai aktivitet specifik konsiston në kornizimin e sjelljes së shtetit me synim që ajo sjellje të zhvillohet brenda kuadrit kushtetues të përcaktuar me kushtetutë nacionale si dokument që përmban normat supreme të një shoqërie me të cilat rregullohet marrëdhëniet e pushtetit (horizontale dhe vertikale) si dhe marrëdhëniet tjera kardinale të natyrës socio–politike, kulturore dhe ekonomike, përfshirë këtu rolin dhe pozitën e individit në shoqëri dhe kundrejt pushtetit. Me kushtetutë nënkuptohet jo vetëm teksti formal që ngërthen normat e normave, pra normat kushtetuese, por edhe praktika, konvencionet dhe çdo aktivitet tjetër që synon ruajtjen e epërsisë së normës kushtetuese, të praktikës dhe konvcencionit kushtetues kundrejt normave, konvencioneve dhe praktikave tjera që nuk kanë statusin kushtetues. Kuptimi formal i kushtetutës, pra si një dokument i shkruar që gjendet në një tekst është më i përhapur nëpër vendet e botës, Kosova bën pjesë në mesin e tyre, kurse kuptimi (joformal) i fundit, është më pak i përhapur dhe kultivohet në ato vende që modelohen sipas sistemit britanik të **common law**.

Me kornizim të sjelljes së shtetit nënkuptohet që shteti të jetë një nga palët e barabarta në shoqëri, që mos të kuptohet vetëm si krijues por si i krijuar dhe si i kufizuar nga normat e një natyre të caktuar – normat kushtetuese. Për më tepër, monopoli i dhunës të cilin e ka shteti nuk duhet nënkuptuar si monopol pa kufi, por si diçka që mund dhe duhet të ushtrohet vetëm në bazë të rregullave të paracaktuara me kushtetutë dhe ligje që burojnë nga kushtetuta, jo si ligje të kuptuara si vullnet suprem i shtetit por si vënie në jetë e vullnetit të të gjithë atyre që bënë marrëveshje për të nxjerrë një kushtetute si rregullator suprem i raporteve vertikale dhe horizontale të pushtetit, i rolit dhe pozitës së individit në shoqëri, si dhe si rregullator i marrëdhënieve të tjera kardinale socio-politike, kulturore dhe ekonomike brenda një shoqërie të organizuar në shtet.

1. HYRJE

Ky kornizim i sjelljes së shtetit brenda rregullave të paracaktuara dhe supreme të lojës së pushtetit dhe rolit e pozitës së individit në të duhet të ketë një mekanizëm institucional. Ky mekanizëm shërben për t'iu treguar të gjithë artereve të kësaj loje të pushtetit dhe të gjithë individëve nëse loja është duke u zhvilluar brenda kornizës kushtetuese të përcaktuar me marrëveshjen e të gjithëve apo nëse loja në fjalë ka dalë nga kjo kornizë kushtetuese. Ky segment thelbësor, i njohur si konstitucionalizëm, ka një mekanizëm të tillë institucional që quhet gjykatë kushtetuese dhe që për funksion primar ka sigurimin e epërsisë së kushtetutës. Në disa vende ky mekanizëm operohet përmes gjykatave të rregullta si pjesë përbërëse e mekanizmit të përgjithshëm të gjyqësorit të rregullt (në **SHBA**, **Greqi**, vendet **Skandinave**, disa vende të **Amerikës Latine**, **Japonia** etj.). Si në rastin e parë ashtu dhe në të dytin qëllim primar i gjyqësisë kushtetuese, që ushtrohet përmes mekanizimit të kontrollit kushtetues të kushtetutshmërisë, është sigurimi i epërsisë së normës kushtetuese ndaj normave të tjera më të ulëta, norma që gjenden në ligje dhe akte tjera më të ulëta se ligji. Në këtë aspekt, gjyqësia kushtetuese nënkuptohet si një gjyqësi që arbitron në mes të artereve kryesorë të pushtetit publik në kontestet dhe mosmarrëveshjet në mes tyre në nivel horizontal dhe vertikal, si dhe si një aktivitet përcaktues i vendit dhe rolit të individit në raport me pushtetin. Ky është definimi, **grosso modo**, i gjyqësisë kushtetuese shikuar nga këndi formal-institucional, pra nga aspekti i rolit dhe funksionit bazik të gjykatës kushtetuese dhe gjykatave të tjera të rregullta, dhe konsiston në sigurimin e epërsisë së normës kushtetuese kundrejt çdo norme tjetër që është më e ulët se ajo.

Përveç kuptimit si më sipër, si një mekanizëm për vënien në jetë të epërsisë së normës kushtetuese kundrejt çdo norme tjetër që është më e ulët se ajo, gjyqësia kushtetuese ka edhe një kuptim tjetër – kuptimin substancial (material). Në këtë kuptim, gjyqësia kushtetuese paraqet një aktivitet publik që synon sigurimin e epërsisë së kushtetutës ndaj çdo norme tjetër duke ruajtur parimet dhe vlerat kushtuese për të gjitha kohërat dhe kundër çdo ndryshimi konjuktural që mund të krijohet pas nxjerrjes së kushtetutës së parë. Ky aktivitet i gjyqësisë kushtetuese nënkupton që epërsia e normës kushtetuese ndaj çdo norme tjetër më të ulët se ajo bëhet duke siguruar që ndryshimet në strukturën materiale (kulturore) të shoqërisë ngelet brenda frymës dhe letrës së tekstit fillestar kushtetues. Kjo arrihet përmes teknikave të interpretimit të cilat i zbaton gjykata kushtetuese (ose gjykata tjetër e rregullt që ushtron këtë funksion) gjatë kryerjes së kontrollit kushtetues. Në këtë aspekt, gjyqësia kushtetuese fokusin e vënë në interpretimin e normës juridiko-kushtetuese në dritën e ndryshimeve thelbësore që ndodhin në strukturën materiale (kulturore) të shoqërisë, duke pasur parasysh këtu edhe ndryshimet që ndodhin lidhur me vendin dhe rolin e individit në shoqëri.

Në kuptimin material (substancial) si më sipër hyjnë disa manifestime të kontrollit kushtetues. Zakonisht ne përdorim fjalën kontroll kushtetues për rastet e kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve. Mirëpo, ky është vetëm një formë e manifestimit të gjyqësisë kushtetuese në kuptimin material (substancial), përkatësisht forma e parë e manifestimit të saj. Kontrolli i legjitimitetit kushtetues të ligjeve sot përbën një **sine qua non** të gjyqësisë kushtetuese. Ky manifestim synon mbrojtjes e epërsisë së kushtetutës në kuadrin e rendit objektiv të hierarkisë së burimeve të së drejtës në një vend. Format tjera të manifestimit të gjyqësisë kushtetuese në kuptimin material (substancial) janë, **inter alia**, edhe: 1. kontrolli kushtetues i aktivitetit publik dhe i çdo aktiviteti tjetër në lëmine e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore; 2. kontrolli kushtetues i legjitimitetit kushtetues të partive politike; 3. kontrolli kushtetues i veprimeve të organeve shtetërore (shefit të shtetit, ministrave dhe zyrtarëve të lartë shtetëror; në këtë rast, gjyqësia kushtetuese vepron si gjyqësi e dhënies së drejtësisë në materien e caktimit të fajësisë për cenim të kushtetutës); 4. kontrolli kushtetues i konfliktit për kompetencë; 5. kontrolli kushtetues i demokracisë (mënyra e formimit të organeve). Këto funksione, përkatësisht këto forma të manifestimit të gjyqësisë kushtetuese nuk janë të përbashkëta për të gjitha shtetet, por vetëm për shtetet e proveniencës së demokracive kushtetuese të tipit perëndimor të cilit i takon edhe **Kosova.**[1]

[1] L. Mezzetti , M. Belletti, E D'Orlando & E. Ferioli, *La Gustizia Costituzionale* (CEDAM : Padova, 2007) fq. 7-20.

Të gjitha këto që u thanë nuk vlejnë për konstitucionalizmin joperëndimor. Konstitucionalizmi perëndimor, të cilit i takon edhe **Kosova**, paraqet një ideologji të kushtetutës ku me kushtetutë nënkuptohet jo vetëm teksti kushtetues, sepse në disa vende, si në **Britani t**ë **Madhe**, ai tekst nuk ekziston, por totaliteti i praktikave, konvencioneve dhe mekanizmave të cilët sigurojnë që autoriteti publik ushtrohet sipas rregullave të paracaktuara mbi ndarjen e pushtetit (vertikale dhe horizontale), duke respektuar të drejtat dhe liritë individuale dhe të minoriteteve si vlera themelore kushtetuese. Konstitucionalizmi joperëndimor, ndërkaq, nuk bazohet në rregullat mbi ndarjen e pushtetit por në rregulla të tjera mbi ushtrimin e pushtetit, si dhe në koncepte e praktika të ndryshme lidhur me rolin dhe pozitën e individit dhe të minoriteteve në shoqëri.

E përbashkëta e dy llojeve të konstitucionalizmave të kuptuara si më sipër është se gjyqësia kushtetuese dhe mekanizmi për vënien e saj në jetë, gjykata kushtetuese ose gjykatat e rregullta që ushtrojnë funksionet e gjyqësisë kushtetuese, synojnë sigurimin e epërsisë së kushtetutës ndaj çdo norme tjetër që është me e ulët se norma kushtetuese. Përveç kësaj pike të përbashkët, pra sigurimi i epërsisë së kushtetutës ndaj normave tjera më të ulëta se norma kushtetuese, konstitucionalizmi joperëndimor ndryshon në çdo aspekt tjetër nga konstitucionalizmi perëndimor, në veçanti sa i përket rolit dhe peshës së individit në shoqëri, të drejtave dhe lirive të tij si dhe të drejtave e lirive të minoriteteve. Kjo epërsi e kushtetutës në vende që përqafojnë konstitucionalizmin joperëndimor sigurohet duke vënë në hierarkinë e burimeve nacionale të së drejtës kushtetuese tekstet apo ideologjitë tjera jashtë kushtetuese, siç janë **Kurani** (në vendet myslimane), ose ideologjia komuniste ose vullneti i liderit nacional (në vendet komuniste ose në vendet tjera si **Gjermania** në kohën e **Adolf Hitlerit** etj). Në këto vende, epërsia e kushtetutës ndaj normave tjera më të ulëta se kushtetuta, pra hierarkia e burimeve të së drejtës, realizohet përmes teksteve dhe ideologjive të cilat operojnë si forcë jashtë kushtetuese dhe si parametër bazë për vlerësim të kushtetutshmërisë. Këto forca sanksionohen si kategori kushtetuese, në sensin që i përmban vetë kushtetuta nacionale si parametër për vlerësim të kushtetutshmërisë së çdo akti juridik, veprimi apo mosveprimi tjetër të organeve publike. Operimi i tyre, ndërkaq, është jashtë kushtetues sepse, në fakt, epërsia e kushtetutës kryhet përmes fuqizimit të teksteve dhe ideologjive që nuk janë pjesë e tekstit kushtetues dhe që shërbejnë si pikë referimi (parametër) për vlerësim kushtetues. Raste tipike të këtij lloji të konstitucionalizmit joperëndimor janë vendet islamike, me kuranin si parametër për vlerësim kushtetues, ideologjia komuniste, në vendet ish-komuniste, vullneti i liderit në vendet totalitare të tipit të **Gjermanis**ë naziste dhe kështu me radhë.

Nga tërë kjo, qartë shihet se thelbi i gjyqësisë kushtetuese është sigurimi i epërsisë së kushtetutës ndaj çdo norme tjetër, qoftë kur kushtetuta gjendet në një tekst apo kur me kushtetutë nënkuptohen ligjet, praktikat dhe konvencionet tjera nacionale të cilat kanë rëndësi dhe peshë kushtetuese (rasti i **Britanis**ë **s**ë **Madhe**). Forma dhe përmbajtja e realizimit të kësaj epërsie të normës kushtetuese përbën esencën e dallimit në mes të konstitucionalizmit perëndimor dhe atij joperëndimor: në rastin e parë, konstitucionalizmi të cilin e mbron gjyqësia kushtetuese konsiston në sigurimin e ndarjes së pushteteve dhe në respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve, kurse në rastin e dytë epërsia e tekstit kushtetues ndodh duke pasur për pikë referimi ndonjë tekst tjetër jashtë kushtetues, siç është **Kurani** në vendet myslimane, apo ndonjë ideologji a vullnet tjetër individual jashtë kushtetues, siç është rasti me ideologjinë komuniste apo me diktaturat e çdo lloji ku vullneti i diktatorit paraqet pikë e referimit me rastin e përcaktimit të hierarkisë së burimeve juridiko-kushtetuese në nivel nacional.

Në të kaluarën ka pasur autorë që kanë thënë se gjyqësia kushtetuese është prodhim i marrëdhënieve ekonomike liberale, i ekonomisë politike të liberalizmit borgjez modern, gjë që nuk është e saktë. Gjyqësia kushtetuese, historikisht shikuar, ka ekzistuar edhe në vendet ish-komuniste kurse aktualisht në vendet myslimane ajo ka një hapësirë të veçantë sado që në këto vende ka një natyrë dhe kuptim krejtësisht tjetër. Ajo çfarë dallon gjyqësinë kushtetuese si një instrument i konstitucionalizmit modern perëndimor, të cilit i takon edhe **Kosova**, dhe atij joperëndimor, lidhet me natyrën dhe mënyrën e ushtrimit të pushtetit publik dhe raportin e këtij pushteti me individin dhe minoritetet.

1.2. Dallimi i gjyqësisë kushtetuese nga format tjera të dhënies së drejtësisë

Ekzistojnë disa dallime në mes të gjyqësisë kushtetuese dhe gjyqësisë së rregullt, të cilat burojnë (dalin):

- nga vetë objekti dhe qëllimi i interpretimit kushtetues krahasuar me interpretimet e që bëhen nga gjyqësori i rregullt;
- nga historia e zhvillimit të këtyre dy llojeve të aktivitetit publik në fushën e ndarjes (dhënies) së drejtësisë;
- nga natyra e interpretimit në lëmin e gjyqësisë kushtetuese krahasuar me gjyqësinë e rregullt; dhe, së fundi,
- nga organi që bën interpretimin si dhe për nga fuqia juridike e interpretimit kushtetues krahasuar me interpretimin e kryer nga gjyqësori i rregullt.

Objekt i interpretimit në gjyqësinë kushtetuese, pa marrë parasysh nëse ai realizohet nga një gjykatë e specializuar apo nga gjyqësori i rregullt, është norma kushtetuese. Kushtetuta çdo herë duhet të kuptohet si tërësi, si një totalitet i teksteve juridike, praktikave, ligjeve dhe konventave (zakoneve), të cilat në një shoqëri të organizuar në shtet rregullojnë (normojnë) natyrën e pushtetit publik, mënyrën e ushtrimit të tij, si dhe rolin dhe pozitën e individit në këtë mes. Në këtë kuptim, kushtetuta përbën vullnetin suprem të sovranit, popullit marrë si tërësi; ajo është marrëveshje historike që ka ndodhur njëherë dhe në një kohë në mes të një gjenerate të qytetarëve (njerëzve) lidhur me pushtetin publik, mënyrën e ushtrimit të tij, si dhe lidhur rolin dhe pozitën e individit në këtë mes. Në të njëjtën kohë, kushtetuta përbën një dokument, një praktikë dhe konvencion (zakon) të gjallë sepse jeton dhe mbijeton gjeneratën që ka arritur marrëveshjen e parë historike. Kjo transcendencë e kushtetutës mundësohet, mes tjerash, edhe përmes mekanizmit dhe mjetit të kontrollit kushtetues si kuadër në të cilin zhvillohet interpretimi në gjyqësinë kushtetuese, interpretim që për objekt të vetëm ka kushtetutën nacionale (në kuptimin formal dhe material). Përmes kontrollit kushtetues, shihet qartë, arrihet synimi primar - sigurimi dhe ruajtja e epërsisë së kushtetutës, e kuptuar si një marrëveshje historike në mes të njerëzve të një kohe, pa marrë parasysh ndryshimet e mëvonshme që mund të ndodhin në strukturën materiale (kulturën) të shoqërisë së organizuar në shtet. Mënyra e jetës, struktura materiale e shoqërisë si tërësi, mund të ndryshojë dhe ndryshon, por epërsia e kushtetutës mbetet postulat që kontrolli kushtetues e synon çdoherë. Për këtë arsye, gjyqësia kushtetuese duhet parë si një mekanizëm institucional kryesor që siguron dhe ruan epërsinë e kushtetutës ndaj çdo norme tjetër përgjatë të gjitha kohërave.

Se kjo është kështu qartë shihet nëse shikohet vetë historiku i zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese. Në rastin **Dr Bonham** çështja që shtrohej ishte nëse ligji i shkruar i parlamentit britanik do të kishte epërsi ndaj **common law** (e drejta e përgjithshme) e cila parqet burimin e parë kushtetues në Angli (pastaj vijnë ligjet e shkruara, konvencionet dhe burimet tjera). Gjykata e Apelit, nën drejtimin e **Sër Edvard Koke** (**Sir Edward Coke: 1552-1634)**, i dha përparësi **common law**, që lejonte **Dr. Bonham** të ushtrojë profesionin e mjekut pa licencë, me kusht që të ketë pëlqimin e pacientit, në ndërkohë që Ligji i **Parlamentit të Britanisë së Madhe** i vitit 1553 fliste për të kundërtën, pra se nuk mund të ushtrohej profesioni i mjekut pa licencë. Përkundër supremacisë parlamentare në **Britanin**ë **e Madhe**, Gjykata e Apelit i dha përparësi **common law**, duke ia njohur të drejtën e ushtrimit të profesionit pa licencë **Dr. Bonham**, gjë që shkonte kundër ligjit të miratuar nga parlamenti britanik. Në këtë rast, megjithatë, nuk u bë shfuqizimi i ligjit në fjalë. Ai ligj ngeli në fuqi kurse çështja u la në harresë, duke i lëshuar vend supremacisë së parlamentit britanik, në vend të supremacisë së kushtetutës britanike ashtu siç ishte interpretuar nga gjykata në rastin **Dr. Bonham.** Për këtë do të flasim sërish më vonë në kapitujt tjerë relevantë që lidhen me lindjen dhe zhvillimin e gjyqësisë kushtetuese, në veçanti në kontekstin britanik (në veçanti kapitulli i katërt).

Supremacia e parlamentit britanik, në kolonitë e saj në Amerikën Veriore, ndërkaq, pati një rrugëtim tjetër. Atje, kjo supremaci u përkthye në një mënyrë që, në fakt, paraqet një paradoks në vetvete: supremacia e parlamentit, në kolonitë amerikane nënkuptonte që kartat kushtetuese të kolonive nuk guxonin të ishin në kundërshtim me legjislacionin pozitiv britanik, pra jo në kundërshtim me **common law** si burim

i parë i Kushtetutës britanike. Kjo nënkuptonte se supremacia e legjislacionit pozitiv britanik kishte tjetër kuptim nëpër kolonitë amerikane meqë kartat kushtetuese të kolonive, të cilat kishin statusin e kushtetutave të kolonive dhe që ishin nxjerrë me bekimin e **Londrës**, duhej të ishin në pajtim jo me **common law** por me legjislacionin pozitiv britanik. Nga gjykatat koloniale, këto ligje britanike interpretoheshin ashtu që çdoherë të konformoheshin me kartat e kolonive të cilat kishin statusin e kushtetutave nacionale për secilën koloni. Një praktikë e tillë gjyqësore prodhoi si pasojë faktin që, pas fitimit të pavarësisë së kolonive dhe themelimit të SHBA-së më 1776, gjyqësori të jetë garant i sigurimit dhe ruajtjes së supremacisë së Kushtetutës së SHBA-së. Ky ka qenë sfondi historik juridiko-kushtetues i lindjes së rastit **Marbury v. Madison**, në të cilin **Gjykata Supreme e SHBA-së** (**GJSSHBA**), nën udhëheqjen e **John Marshall**, e dha verdiktin i cili vërtetonte supremacinë e Kushtetutës ndaj ligjeve pozitive, si dhe të drejtën e pa kontestuar të gjyqësorit amerikan për të bërë kontrollin kushtetues të ligjeve me rastin e vendosjes për raste dhe mosmarrëveshje të natyrës penale, civile dhe administrative.[2]

Shekulli në vijim, përveç në **Zvicër**, dhe në fund të shekullit edhe në **Norvegji** dhe Danimarkë, nuk pati ndonjë rast ku shtetet treguan ndonjë interesim për kontroll kushtetues të ligjeve dhe akteve të tjera më të ulëta se ligji. Në **Amerikën Latine**, në **Meksik**ë dhe **Urugvaj**, po ashtu pati disa përpjekje të gjykatave supreme që përmes institucionit **amparo** të legjitimojnë kontrollin kushtetues të ligjeve. Shekulli tjetër, shekulli njëzet, pati një kahje tjetër, më të ndritur sa i përket kontrollit kushtetues: në **Austri** u themelua Gjykata Kushtetuese nën udhëheqjen e **Hans Kelsen**, kurse në **Gjermaninë e Vajmarit** në vitin 1925 u dha një verdikt nga **Gjykata e Rajhut** me të cilin pranohej se Kushtetuta duhej të kishte epërsi absolute ndaj normave të tjera juridike.

Tragjedia e **Luftës së Dytë Botërore** bëri që shumë institucione të krijuara në mes të dy luftërave botërore të ridimensionoheshin nga një kënd tjetër. Vendet si **Italia, Gjermania** dhe **Japonia** pranuan se sistemet e qeverisjes nga e kaluara kishin qenë të dëmshme, jo vetëm për to dhe popujt e tyre por edhe për vendet dhe popujt tjerë. Kjo rrethanë bëri që në këto vende të përqafohej praktika e re sipas së cilës vullneti i shumicës i shprehur nëpër ligje duhej kontrolluar përmes rrugëve gjyqësore për të mos dalë kundër normës kushtetuese, siç kishte ndodhur në të kaluarën e tyre të hidhur. Themelimi i gjykatave kushtetuese në **Itali** dhe Gjermani si dhe rikrijimi i **Gjykatës Kushtetuese të Austris**ë shënon valën e parë të zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese. Këto gjykata u themeluan pak a shumë si rezultat i kompromitimit të tërësishëm të gjyqësorit të rregullt në këto vende, ashtu që tani duhej zbuluar një organ të ri, gjykatën kushtetuese, për të kontrolluar vullnetin e shumicës dhe ushtrimin e pushtetit për të siguruar që raporti i individit me pushtetin të transformohet në mënyrë radikale me qëllim të sigurimit të një lirie të plotë individuale me të drejta më përmbajtjesore se sa kishte qenë rasti më herët. Në **Japoni**, ky rol iu besua **Gjykatës Supreme** e cila u modelua sipas sistemit amerikan, diçka ngjashëm që kishte edhe ndodhur edhe ne vendet tjera të **Evropës**. Proliferimi i gjyqësisë kushtetuese, qoftë përmes themelimit të gjykatave të reja të ndara kushtetuese, si në **Qipro**, **Turqi**, apo në Portugali dhe gjetiu, ose përmes besimit të këtij funksioni gjykatave më të larta ne vend sipas modelit amerikan, bëri që institucioni i gjyqësisë kushtetuese të shihet si mjet i mirë për demokratizim dhe zhvillim të konstitucionalizmit liberal.

Vala e fundit e themelimit të gjykatave kushtetuese, pas rënies së komunizmit më 1990, tregoi sërish se gjyqësia kushtetuese ka për bazë të vet themelimi ikjen nga gjyqësori i rregullt, i cili ishte kompromet uar gjatë kohës së komunizmit: tani ngelej vetëm themelimi i institucioneve të kompetencës së posaçme, i gjykatave kushtetuese, si institucione të reja pa asnjë hipotekë nga e kaluara e kompromet uar komuniste. Në të gjitha vendet ku u themeluan gjykatat e reja kushtetuese, gati në të gjitha vendet ish-komuniste, ato luajtën një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në demokratizmin dhe zhvillimin e konstitucionalizmit të proveniencës liberale në këto vende.

Sa i përket dallimit të gjyqësisë kushtetuese nga gjyqësori i rregullt si pasojë e natyrës së interpretimit që kryhet në këto dy lloje të dhënies së drejtësisë, duhen thënë disa fjalë që lidhen me vetë esencën e

[2] Mauro Cappelletti , *The Judicial Process in Comparative Perspective* (Clarendon Press: Oxford, 1989) fq. 126-132.

debatit lidhur me këtë çështje, debat tanimë historik, në mes të **Hans Kelsen** (Hans Kelsen: 1881-1973) dhe **Karl Shmit** (Carl Schmitt: 1888-1985). Ky debat është zhvilluar në mes të viteve njëzet të shekullit të kaluar dhe ka konsistuar në sa vijon: sipas H. Kelsen, arkitektit ideor të gjyqësisë kushtetuese, gjyqësia kushtetuese duhet të jetë e ndarë nga gjyqësori i rregullt dhe duhet të ketë si detyrë primare kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve. Pra, sipas tij, subsumcioni (silogjizmi) gjyqësor në këtë lloj të gjyqësisë bëhet duhet e krahasuar një normë më të ulët se kushtetuta me normën kushtetuese, pra duke e vënë normën më ulët se norma kushtetuese, përmes operacionit mendor të njohur si subsumcion (silogjizëm) gjyqësor, nën normën kushtetuese si normë më e lartë. Në këtë lloj të ndarjes së drejtësisë, si fakt (kushtetues) që duhet vërtetuar është rrethana nëse një normë më e ulët se kushtetuta bie ndesh me një normë kushtetuese. Sipas **K. Shmit**, ndërkaq, ky lloj i gjyqësisë është absurd në vetvete sepse nuk ka kuptim operacioni mendor i subsumcionit (silogjizmit) gjyqësor të një norme më të ulët me një normë tjetër më të lartë por vetëm silogjizmi (nenvënia) i një norme juridike kundrejt një gjendje faktike. Kjo vlen për të gjitha procedurat: penale, civile dhe administrative. E thënë me fjalë të tjera, sipas tij nuk mund të ekzistoje gjykimi i një norme përmes një norme tjetër por vetëm i një fakti kundrejt një norme.

Koha dëshmoi, megjithatë, se **H. Kelsen** ka pasur të drejtë. Kjo për arsye se, sikundër dihet, sot gjerësisht është i përhapur si profesion kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjeve dhe normave të tjera më të ulëta se ligji, funksion ky primar i gjyqësisë kushtetuese dhe vetë arsyeja e lindjes së saj në të dy anët e **Atlantikut**. Juridiksioni tjetër i gjyqësisë kushtetuese që ka të bëjë me mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, gjykimi i funksionarëve të lartë të pushtetit (**impeachment**-i), kontrolli kushtetues i aktivitetit të partive politike dhe kështu me radhë kanë lindur më vonë. Sidoqoftë, kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjeve dhe normave të tjera më të ulëta se ligji paraqet funksionin klasik dhe vetë arsyen e lindjes së gjyqësisë kushtetuese në të gjitha vendet ku gjyqësia kushtetuese është e ndarë nga gjyqësori i rregullt. Në vendet tjera ku gjyqësia kushtetuese zhvillohet në kuadër të ushtrimit të kompetencave të përgjithshme të gjyqësorit të rregullt, gjyqësia kushtetuese kryhet si pjesë e aktivitetit rutinor me rastin e vendosjes së rasteve dhe mosmarrëveshjeve konkrete të natyrës civile, penale apo administrative. Ky dallim është vetëm në model të strukturimit të kontrollit kushtetues: esenca e qëllimit të funksionit të gjyqësisë kushtetuese ngelet e njëjtë – sigurimi i supremacisë (epërsisë) së kushtetutës si akt me fuqi normative.

Sikundër shihet, dallimet si më sipër në modelin e gjyqësisë kushtetuese rrjedhin nga natyra e organit që e bën interpretimin si dhe nga vetë fuqia juridike e interpretimit kushtetues krahasuar me interpretimin e kryer nga gjyqësori i rregullt. Gjyqësia kushtetuese bashkëkohore kryesisht asocohet me kontrollin gjyqësor të centralizuar, i cili kryhet nga institucionet e posaçme të cilat emërtohen si gjykata kushtetuese. Në modelin tjetër, atë të decentralizuar, interpretimin e kushtetutës e bëjnë organet tjera kushtetuese, si gjyqësori i rregullt dhe institucionet tjera. Modeli i decentralizuar dominon në **SHBA**-në ku interpretimi i kryer nga një gjykatë gjatë vendosjes për një rast apo mosmarrëveshje vlen vetëm për atë rast apo mosmarrëveshje. Për dallim nga **SHBA**-ja dhe vendet tjera të sistemit të decentralizuar të kontrollit të kushtetutshmërisë, në të cilat çdo gjykatë ka të drejtën e kontrollit kushtetues me efekt vetëm për një rast apo mosmarrëveshje konkrete, si dhe të drejtën që të mënjanojë dhe moszbatojë ligjin e dyshuar si antikushtetues, në vendet tjera ku gjyqësia kushtetuese është e ndarë nga gjyqësia e rregullt, kjo e fundit nuk ka të drejtë që të mënjanojë ligjin që dyshohet për kundër kushtetutshmëri. Në një rast të tillë, gjykata dyshuese duhet ta ndalë procedurën dhe ta nisë rastin për kontroll kushtetutës në gjykatën nacionale kushtetuese. Kjo procedurë quhet procedura e **kontrolli kushtetues incidental** dhe diskutohet më vonë në kapitull e katërt të këtij libri kur të flitet për sistemet e kontrollit kushtetues në vendet e demokracive kushtetuese liberale.

Ekziston edhe modeli i tretë, i njohur si **modeli i përzier** i gjyqësisë kushtetuese, kur krahas interpretimit të cilin e bën gjykata kushtetuese, dhe i cili është përfundimtar e i detyrueshëm për të gjithë, gjyqësori i rregullt kryen interpretime të kushtetutës por që nuk e kanë këtë fuqi juridike. Interpretimet tjera nuk janë të veshura me këtë fuqi juridike dhe janë interpretime rutinore të kushtetutës që vlejnë vetëm për një rast apo mosmarrëveshje konkrete. Në Kosovë dhe në shumicën e vendeve që kanë gjyqësi të ndarë kushtetuese, gjyqësorit të rregullt nuk i lejohet të bëjë interpretimet e kushtetutës: në rast të dyshimit

për ndonjë jo kushtetutshmëri të një normë juridike, procedura ndalet dhe çështja i kalohet gjykatës kushtetuese nacionale. Në sistemin e përzier, gjyqësori i rregullt ka të drejtë të bëjë një gjë të tillë, por sërish është gjykata kushtetuese nacionale është kompetente për të dhënë fjalën përfundimtare lidhur me kushtetutshmërinë e një ligji, akti tjetër juridik, veprimi ose mosveprimi. Ky sistem ekziston në **Portugali** dhe në disa vende të **Amerikës Latine**,[3] të cilat i diskutojmë në kapitujt katër dhe gjashtë të këtij libri.

1.3. Vendi i gjyqësisë kushtetuese në sistemin nacional të drejtësisë

Në vendet ku ekziston një kontroll kushtetues i decentralizuar, të gjitha gjykatat e vendit kanë të drejtën e ushtrimit të gjyqësisë kushtetuese gjatë zgjidhjes së rasteve dhe mosmarrëveshjeve konkrete të natyrës penale, civile apo administrative. Në vendet ku ekziston sistemi i centralizuar i gjyqësisë kushtetuese, vetëm gjykata kushtetuese e ka të drejtën e ushtrimit të kontrollit kushtetues në mënyrë përfundimtare dhe me autoritet të plotë. Në rastin kur kjo e drejtë iu njihet krahas gjykatave kushtetuese edhe gjykatave të rregullta, siç është rasti me **Portugalin**ë, atëherë bëhet fjalë për një **sistem t**ë **p**ë**rzier**. Në këtë sistem, megjithatë, asnjëherë nuk vihet në pyetje fuqia juridike e plotë dhe përfundimtare e kontrollit kushtetues që ushtrohet nga gjykata kushtetuese, e cila në të njëjtën kohë merr parasysh interpretimin e bërë nga gjykatat e rregullta me rastin e vendosjes së një rasti ose mosmarrëveshjeje konkrete.

Në sistemin e decentralizuara, gjyqësia kushtetuese ushtrohet si pjesë e gjyqësorit të rregullt ashtu që edhe vetë profesioni i gjyqësisë kushtetuese është profesion karriere dhe nuk dallon nga funksioni gjyqësor si tërësi. Mirëpo, ka zgjidhje kushtetuese, siç është rasti me **Polonin**ë dhe disa vende të tjera, kur në kushtetutën nacionale gjykata kushtetuese figuron si pjesë e sistemit të rregullt gjyqësor. Kjo, megjithatë, nuk e ndryshon rrethanën që gjykata kushtetuese përbën një institucion të ndryshëm nga gjyqësori i rregullt dhe nuk është vokacion i karrierës. Gjyqtarët kushtetues dallojnë nga gjyqtarët e karrierës sepse nuk kalojnë shkallët e ngritjes në karrierë sipas procedurave të cilat zbatohen ndaj gjyqtarëve të rregullt. Në vendet ku gjyqësia kushtetuese ushtrohet nga gjykatat kushtetuese, për dallim nga gjyqësori i rregullt, nuk ekziston një këshill gjyqësor apo ndonjë organ tjetër që të mbikëqyrë apo menaxhon punët e gjykatës kushtetuese. Kjo mbikëqyrje apo ky menaxhim kryhet nga vetë gjykata kushtetuese dhe përbën pjesë të pandarë të pavarësisë së saj institucionale dhe pavarësisë tjetër në kuadër të ushtrimit të juridiksionit të vet të përcaktuar me kushtetutën e vendit. Gjyqësori i rregullt, ndërkaq, siç dihet, mbikëqyrët dhe menaxhohet nga ana e këshillit gjyqësor apo ndonjë organi tjetër i ngjashëm me këshillin gjyqësor sa i përket kompetencave të menaxhimit dhe mbikëqyrjes.

Në vendet me sistem të centralizuar, pra në vendet me sistem **kelsenian/evropian**, siç njihet ndryshe, gjyqësia kushtetuese përbën një institucion me juridiksion të posaçëm krahasuar me juridiksionin e përgjithshëm të gjyqësorit të rregullt, kurse gjyqtarët e saj janë gjyqtarë që rekrutohen (vijnë) jo nga profesioni i karrierës por nga akademia dhe nga profesionet e tjera që nuk i nënshtrohen avancimeve dhe ngritjeve tjera në profesion dhe detyrë (siç ndodhë me gjyqësorin e rregullt dhe me profesionet tjera të karrierës). Edhe pse gjykata kushtetuese në këto vende mund të figurojë në kuadër të sistemit gjyqësor, në aspektin formal ajo konsiderohet si një institucion i ndarë nga gjyqësori i rregullt. Kjo do të thotë se ajo nuk konsiderohet si pushtet gjyqësor i ndarë nga pushteti legjislativ dhe ekzekutiv, por thjesht si një organ i kontrollit kushtetues të kushtetutshmërisë (dhe ligjshmërisë në disa vende), i cili vepron sipas autorizimit shprehimor kushtetues. Më një fjalë, gjykata kushtetuese në këto vende nuk cilësohet si pushtet gjyqësor, pra si pjesë e njërit prej tri pushteteve të ndara dhe të balancuara, por si një pushtet i veçantë

[3] Për rastin e **Portugalisë**, cf. Antonio Cortes & Teresa Violante, "Concrete Control of Constitutionality in Portugal: A Means Towards Effective Protection of Fundamental Rights". *Penn State International Law Review*: Vol. 29 No. 4, Article 3 (2011) fq. 759-776; Për vendet e **Amerikës Latine**, cf. më shumë në Justin O. Frostini & Lucio Pergoraro, "Constitutional Courts in Latin America: A Testing Ground for New Parameters of Classification". *Journal of Comparative Law* Vol.Issue 2 (2008) fq. 38-63 (ku autorët tregojnë për lindjen e gjyqësisë kushtetuese në **Amerikën Latine**, ndikimin e fuqishëm amerikan në fillim të saj, zhvillimin e kësaj gjyqësie përgjatë shekullit 20 dhe ndikimin evropian në te, në veçanti ndikimin gjerman përmes **Spanjës**, por edhe ndikimin e sistemit portugez të përzier të gjyqësisë kushtetuese. Autorët theksojnë se, në fakt, sistemi i përzier nuk është sistem derivativ i dy sistemeve të tjera të gjyqësisë kushtetuese, por përbën një sistem në vete dhe që ka një fizionomi autonome nga dy sistemet klasike të gjyqësisë kushtetuese (sistemit të centralizuar dhe sistemit të decentralizuar).

publik që tagrin e vet për të vepruar e nxjerr nga kushtetuta duke iu nënshtruar asaj në tërësi, nisur nga fakti se detyrim primar i gjyqësisë kushtetuese është sigurimi dhe ruajtja e epërsisë së kushtetutës ndaj çdo burimi tjetër të së drejtës. U mor vesh, në vendet myslimane, epërsia e kushtetutës nuk bëhet duke shërbyer si parametër kushtetutës vetë ajo, por burimet tjera të së drejtës kushtetuese që cilësohen si me origjinë hyjnore: **Kurani** dhe **Hadithet** (në disa vende edhe burimet tjera) paraqesin pikën e referimit për të gjykuar mbi kushtetutshmërinë e ligjeve dhe veprimeve e mosveprimeve të tjera publike. Në këto vende, si dhe në vendet tjera ish-komuniste, gjykatat kushtetuese dhe gjyqësia kushtetuese është cilësuar edhe si një organ politik për shkak të natyrës së çështjeve kushtetuese të cilat ndonjëherë paraqiten për zgjidhje pranë saj. Këto dhe çështjet lidhur me këto do të jenë objekt i shqyrtimeve të mëtejme të këtij libri në kapitujt pesë dhe shtatë.

1.4. Plani i librit

Libri ndahet në dy pjesë. Pjesa e parë ka nëntë kapituj e pjesa e dytë shtatë.

Kapitujt e pjesës së parë të librit bëjnë fjalë për aspektet teoriko-filozofike dhe praktike të lindjes dhe zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese, që nga antikiteti e deri më sot. Kapitujt e pjesës së dytë, ndërkaq, trajtojnë më nga afër aspektet juridiko-pozitive të gjyqësisë kushtetuese kosovare, shikuar nga këndvështrimi komparativ. Kjo ngërthen trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me caktimin e gjyqtarëve të gjykatës kushtetuese, juridiksionin e **Gjykatës Kushtetuese të Kosovës** (**GJKK**), lindjen dhe zhvillimin e saj, natyrën juridike të vendimeve të gjykatave kushtetuese, nivelin e aktivizmit gjyqësor të këtyre gjykatave dhe kontekstin kulturor në të cilin ndodh një gjë e tillë dhe tema të tjera si këto, për të përfunduar me trajtimin selektiv të rasteve më pikante të gjyqësisë kushtetuese në Kosovë në dekadën e parë të themelimit të saj (2009-2019). Mbesim me shpresë se dekada e dytë e punës së **GJKK-së** do të jetë më e pasur me trajtime doktrinare të vendimmarrjes së saj, njëjtë siç ndodh në vendet e tjera evropiane dhe përtej **Atlantikut.** Jemi të bindur se vetëm kësisoj promovohet dhe ngritët cilësia në vendimmarrje dhe zhvillohet jurisprudenca kushtetuese ndër ne.

Në fund të secilit kapitull janë dhënë komentet dhe pyetjet tona sfiduese me qëllim që të tundojmë lexuesit e librit për një analizë dhe lexim shtesë. Kjo analizë dhe ky lexim shtesë çdoherë është kontekstuale dhe lidhet me fundin e secilit kapitull veç e veç. Leximi shtesë që jepet në fund të secilit kapitull nuk nënkupton literaturën dhe burimet e përdorura për prodhimin e kapitullit në të cilin figurojnë. Kështu kemi bërë për secilin kapitull, përfshirë dhe atë të fundit që trajton praktikën pikante të dekadës së parë të zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese.

Leximi shtesë jepet në fund me qëllim të ngritjes së vetëdijes së lexuesit për literaturën më të re dhe më interesante që i referohet kapitullit që e shoqëron. Për qëllimet e analizës dhe diskutimit tonë në këtë kapitull, megjithatë, ne kemi përpunuar secilën literaturë të dhënë si lexim shtesë në fund. Këtë e bëjmë me qëllim që lexuesi që shfleton këtë literaturë të kuptojë nga afër rëndësinë konkrete të saj në lidhje me dimensionet e caktuara të gjyqësisë kushtetuese kosovare, dimensione që përfshihen në kapitujt e këtij libri. As ky kapitull, hyrja e librit, nuk bën përjashtim në këtë aspekt.

Ata që e përdorin këtë libër me studentë, nuk përjashtohet mundësia që, bazuar në komente gjatë ligjëratave, të ndërtojnë raste konkrete apo të përpunojnë rastet ekzistuese të dhëna në këtë libër, e që kanë të bëjnë me gjyqësinë kushtetuese (vendore dhe të huaj), me qëllim që të njëjtat të shtjellohen gjatë mësimit apo edhe gjatë provimit. Krejt kjo me qëllim të konkretizimit të jurisprudencës kosovare të gjyqësisë kushtetuese në universin evropian.

Shënojmë fare në fund që, secili kapitull është **autonom,** si sa i përket përdorimit të literaturës dhe burimeve të tjera që figurojnë nëpër fusnota ashtu edhe sa i takon citimit të tyre. Kjo do të thotë se çdo gjë nis nga fillimi dhe përdoret sërish në tekst përgjatë tërë kapitullit sikur ai të ishte një libër i ndarë më vete në mënyrë autonome. Kjo vlen edhe për **shkurtesat**, të cilat jepen në fillim në pjesën për shkurtesat. Këtë metodologji, jo fort të zakonshme, e kemi përzgjedhur me qëllim të lehtësimit të përdorimit të këtij libri.

1.5. Komente dhe pyetje

1.5.1. Gjyqësia kushtetuese kuptohet si një aktivitet publik institucional përmes të cilit sigurohet supremacia e kushtetutës kundrejt normave të tjera më të ulëta se normat kushtetuese. Kontrolli kushtetues paraqet instrumentin apo mjetin përmes të cilit realizohet kjo epërsi. Kushtetuta paraqet vullnetin e të gjithëve, marrëveshjen e të gjithëve për sa i përket mënyrës së qeverisjes si dhe rolit e pozitës së individit në një shoqëri të organizuar në shtet. Ligji, normat, veprimet dhe mosveprimet e autoriteteve publike, ndërkaq, paraqesin vullnetin e shtetit dhe institucioneve të tjera në të, të individëve dhe grupimeve e segmenteve të caktuara, pra vetëm fraksionin e vullnetit që nuk mund të futet në kategorinë e asaj që paraqet marrëveshje nacionale kushtetuese. Cila është rëndësia e kontrollit kushtetues përmes së cilit manifestohet ushtrimi i gjyqësisë kushtetuese si profesion?

1.5.2. Në të njëjtën kohë, gjyqësia kushtetuese paraqet një mekanizëm institucional kurse kontrolli kushtetues paraqet një aktivitet dhe mjet primar përmes të cilit jepet drejtësia që ka natyrë kushtetuese. Ky kontroll ka të bëjë me kontrollin kushtetues të ligjeve dhe normave të tjera më të ulëta se ligji, aktivitetit të partive politike, akteve individuale të autoriteteve publike (legjislative, administrative dhe gjyqësore), kontrollin kushtetues të veprimeve të shefit të shtetit dhe funksionarëve të tjerë publikë dhe kështu me radhë. Pra, juridiksioni i gjyqësisë kushtetuese varet nga dizajni kushtetues nacional. Ky juridiksion dhe kontrolli kushtetues si aktivitet konkret dhe mjet përmes të cilit realizohet gjyqësia kushtetuese kanë për synim kornizimin e veprimit të shtetit ashtu që ai veprim mos të dalë jashtë parametrave të paracaktuar me kushtetutë. Ata parametra konsistojnë, në mes tjerash, në sundimin e ligjit, ndarjen dhe balancimin e pushteteve, mbrojtjen dhe promovimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve etj. Këto parametra paraqesin pikën e referimit për dallimin e llojeve të konstitucionalizmit bashkëkohor. Ky konstitucionalizëm, sot për sot, vihet në jetë në dy mënyra, përkatësisht përmes dy llojeve të gjykatave kushtetuese, të cilat reflektojnë llojet përkatëse të modeleve të gjyqësisë kushtetuese. Cilat janë llojet e gjykatave përmes të cilave vihet në lëvizje konstitucionalizmi në botën e sotme (perëndimor dhe joperëndimor)?

1.5.3. Gjyqësia kushtetuese paraqet një aktivitet publik dhe një mekanizëm institucional për dhënien e drejtësisë kushtetuese. Në këtë kuptim, gjyqësia kushtetuese përmes kontrollit kushtetues jep drejtësi kushtetuese dhe vë në jetë konstitucionalizmin si ideologji të kushtetutës. Në botën perëndimore, konstitucionalizmi konsiston në sigurimin e epërsisë së normës kushtetuese përmes rregullimit të ndarjes dhe balancimit të pushtetit dhe sigurimit të lirive dhe të drejtave të individit dhe të minoriteteve. Në botën joperëndimore, ndërkaq, sigurimi i epërsisë së normës kushtetuese arrihet në mënyrë krejtësisht tjetër, përkatësisht përmes mekanizmave dhe forcave jashtëkushtetuese. Cili është elementi i përbashkët i dy konstitucionalizmave, atij perëndimor dhe atij joperëndimor? Cilat janë ato forca jashtëkushtetuese që ndikojnë në sigurimin e epërsisë së kushtetutës në kuadrin e hierarkisë së burimeve nacionale të së drejtës në vendet joperëndimore?

1.5.4. Ekzistojnë disa dallime në mes të gjyqësisë kushtetuese dhe gjyqësisë së rregullt. Janë disa kritere mbi bazën e të cilave ndodh ky dallim. Cilat janë këto dallime dhe mbi cilat kritere bëhen dallimet në mes të gjyqësorit të rregullt dhe gjyqësisë kushtetuese?

1.5.4. Transportimi i përvojës britanike me supremacinë parlamentare në kolonitë e Amerikës Veriore, historikisht shikuar, ka pasur një efekt krejtësisht tjetër: në kolonitë britanike kartat kushtetuese të kolonive kishin statusin e kushtetutës dhe duhej të ishin në pajtim me legjislacionin pozitiv britanik, pra jo në pajtim me **common law**, e cila sot e kësaj dite është burim primar i të drejtës kushtetuese britanike. Çfarë nënkuptonte kjo gjendje në kohën kur është vendosur rasti **Marbury v. Madison**?

1.5.5. Vala e parë e krijimit të gjykatave kushtetuese (**Italia, Gjermania**) dhe rithemelimi i **Gjykatës Kushtetutese të Austrisë** (**GJKAu**), si dhe krijimi i gjykatave nacionale që kishin juridiksion për të kryer kontroll kushtetues të ligjeve si pjesë e juridiksionit të tyre të zakonshëm (Japonia) u bë për të njëjtat arsye që çuan në lindjen e valës së dytë të përhapjes së gjyqësisë kushtetuese pas rënies së komunizmit.

Cilat është arsyeja kryesore që është e përbashkët në rastet e përhapjes së gjyqësisë kushtetuese pas **Luftës së Dytë Botërore** dhe pas rënies së komunizmit?

1.5.6. Debati në mes të **Hans Kelsen** dhe **Karl Shmit** lidhur me natyrën e gjyqësisë kushtetuese paraqet esencën e dallimit në mes të gjyqësisë kushtetuese dhe gjyqësisë së rregullt. Cila është esenca e këtij debati?

1.5.7. Organi që bën interpretimin përcakton edhe efektet e tij. Në vendet ku organi quhet gjykatë kushtetuese, i ndarë nga gjyqësori i rregullt, atëherë ai organ vetë e bën interpretimin e detyrueshëm dhe përfundimtar të kushtetutës. Kjo është kështu për shkak se këto organe të ndara janë të tilla sipas kushtetutës nacionale, e cila i përcakton kompetencat e tyre të posaçme për interpretim përfundimtar të kushtetutës, duke përjashtuar krejt organet tjera shtetërore nga kjo kompetencë. Edhe në këto vende, organet dhe institucionet tjera, përfshirë gjyqësorin e rregullt, kanë të drejtë të bëjnë interpretime të kushtetutës nacionale. Në këtë aspekt, sistemi i gjyqësisë së ndarë kushtetuese ngjason me vendet me sistem të decentralizuar të kontrollit kushtetues, siç është rasti me SHBA-në dhe vendet tjera. Në këto vende, siç dihet, çdo gjykatë e rregullt ka mandat për të bërë interpretime të kushtetutës gjatë vendosjes për rastet dhe mosmarrëveshjet konkrete të natyrës penale, civile apo administrative. Megjithatë, në vendet ku gjykatat kushtetuese janë të ndara nga gjyqësori i rregullt ekziston një dallim i veçantë sa i përket cilësisë së interpretimit dhe efekteve të tij, cilësi kjo që nuk gjendet në SHBA dhe në vendet tjera të sistemit të decentralizuar të gjyqësisë kushtetuese. Cili është ky dallim?

1.5.8. Vendi i gjyqësisë kushtetuese në sistemin nacional të drejtësisë diktohet nga sistemi i kontrollit të kushtetutshmërisë: në vendet me sistem të decentralizuar, gjyqësia kushtetuese është pjesë e gjyqësisë së rregullt, dhe anasjelltas, në vendet me sistem të centralizuar, gjyqësia kushtetuese është një aktivitet i cili ushtrohet në kuadër të juridiksionit të posaçëm të përcaktuar me kushtetutë. Ka raste që, në aspektin formal, gjykata kushtetuese figuron si pjesë e sistemit të rregullt gjyqësor, por kjo nuk e ndryshon faktin se në këto vende, si në vendet tjera me sistem të centralizuar, gjykata kushtetuese nuk është pjesë e asnjërit prej tri pushteteve: pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Kjo vlen edhe për vendet myslimane dhe vendet ish-komuniste, ani se në këto vende nuk ekziston koncepti kushtetues i ndarjes së pushteteve. Cilat janë cilësitë e përbashkëta të vendeve që i takojnë konstitucionalizmit liberal, ato myslimane dhe ish-komuniste, sa i përket vendit dhe rolit të gjyqësisë kushtetuese në sistemin kushtetues nacional?

1.6. Lexim shtesë

- Mauro Cappelletti and William Cohen , *Comparative Constitutional Law. Cases and Materials* (The Bobbs – Merrill Company , Inc.: USA, 1979)
- Gustavo Zagrebelsky, *La Guistizia Constitutzionale* (Il Mulino: Bologna, 1988)
- Tom Ginsburg and Rosalin Dixon, *Comparative Constitutional Law* (Edëard Elgar: UK/USA, 2011)
- Michel Rosenfeld and Andras Sajo (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law* (Oxford, 2012)
- Dominique Chagnollaud, *Droit constitutionel contemporain. 1. Theorie generale . Les regimes etrangers* (Dalloz: Paris, 2013)
- Mark Tushnet, Thomas Fleiner and Cheryl Saunders (eds.), *Routledge Handbook of Constitutional Law* (Routledge: London and New York, 2013).

PJESA E PARË

ASPEKTE FILOZOFIKE-TEORIKE MBI ORIGJINËN, ZHVILLIMN DHE KONTEKSTIN SHOQËROR TË LINDJES SË KONTROLLIT KUSHTETUES NËPËR VENDE E SISTEME TË NDRYSHME, ME VËSHTRIM TË VEÇANTË NË BOTËN EURO-ATLANTIKE

2. ORIGJINA: ASPEKTE FILOZOFIKE-TEORIKE DHE KONTEKSTI SHOQËROR

Përgjithësisht. - Në këtë pjesë diskutojmë aspektet filozofike-teorike dhe kontekstin shoqëror në të cilin ka lindur ideja dhe praktika e kontrollit gjyqësor. Ky trajtim është shumë telegrafik dhe gjithëpërfshirës, nëse merret parasysh se trajtimi ynë nis me kohën antike dhe vjen deri te ditët tona.

Ideja e këtij kapitulli është që lexuesit t'ia ofrojë një pasqyrë shumë të thukët e gjithëpërfshirëse lidhur me origjinën e idesë dhe praktikës së kontrollit kushtetues, si dhe lidhur me kontekstin shoqëror që ka prodhuar këtë ide dhe praktikë.

Në fillim, në seksionin e parë, lexuesit i ofrohet një pasqyrë historike e teorisë dhe praktikës së bazuar në botëkuptimet mbi një rend superior, më të lartë se të tjerët, por që nuk ka poseduar me ndonjë mekanizëm për sigurimin e epërsisë së vet. Këtu lexuesi do të gjejë shtjellimet tona për kohën **greko-romake**, **Mesjetën**, përvojat e **Venedikut**, rolin e interpretimit gjyqësor të rendit ekzistues juridik, tanimë të racionalizuar nën ndikimin e ideve iluministe, si dhe për rolin vendimtar që kanë luajtur kushtetutat e shkruara në ndërtimin e mekanizmave dhe gradacioneve kushtetuese. Vetëm me kushtetutat e shkruara janë krijuar parakushtet themelore për sigurimin e supremacisë (epërsisë) së rendit të bazuar në tekstin e kushtetutës në mënyrë institucionale dhe me mekanizma adekuatë. Deri atëherë ka mundur të bëhet fjalë vetëm për ekzistimin e botëkuptimeve për një rend superior, të lartë, kundrejt rendeve të tjera më të ulëta. Këto botëkuptime kanë ekzistuar gjatë tërë kohës, që nga koha greko-romake e deri në nxjerrjen e kushtetutave të para pas revolucioneve në Amerikë dhe Francë. Përvoja njerëzore është bazuar mbi këto botëkuptime, siç do të shihet me rastin e **Greqisë**, **Romës**, **Venedikut** dhe **Britanisë së Madhe**. Kjo gjendje ka ndryshuar në momentin kur interpretimi gjyqësor ka ndodhur në kontekstin e ekzistimit të një teksti të shkruar kushtetues. E kemi fjalën për rastin historik të **Marbury v. Madison**, të vendosur në **SHBA** nga Gjykata Supreme (**GJSSHBA**) në vitin 1803.

Në seksionin e dytë, lexuesit i ofrohet përvoja franceze me gjyqësinë kushtetuese. Në fillim tregohet se si në këtë vend ka pasur rezerva të mëdha ndaj kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë së ligjeve. Kjo rezervë vinte si pasojë e kompromet imit të madh të gjyqësorit në kohën e regjimit mbretëror, për të shërbyer edhe si një shkak i drejtpërdrejtë i nisjes së procesit të kodifikimit në Francë. Ideja themelore e revolucionarëve francezë pas vitit 1789, ka qenë që vullneti i sovranit nuk mund të kontrollohet nga askush veç tij, në veçanti jo nga gjyqtarët e regjimit të vjetër mbretëror, të cilët verbërisht i kishin shërbyer kurorës. Me kalimin e kohës, megjithatë, u pa se kjo nuk mund të bëhej dhe se interpretimi gjyqësor nuk do të mund të përjashtohej në tërësi nga përvoja jetësore. Kjo fazë deri këtu njihet si kontroll politik i kushtetutshmërisë, ku vetëm organet brenda ligjvënësit francez lejohej të bënin një lloj kontrolli preventiv të ligjeve, por vetëm politikisht. Kjo fazë u pasua nga kontrolli gjyqësor dhe gjysmë-gjyqësor, që evoluoi përgjatë shekujve deri në kohën e sotme ku organet gjyqësore dhe gjysmë-gjyqësore kryejnë autorizime të fuqishme në lëmin e kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe veprimeve e mosveprimeve të tjera të autoriteteve shtetërore franceze. Këtu hyjnë edhe trajtimet tona lidhur me liritë e të drejtat e njeriut si dhe ndikimin e tyre në këtë sferë.

Seksioni i tretë merret me përvojën amerikane të gjyqësisë kushtetuese. Në fillim diskutohet ideja dhe praktikat e të ashtuquajturave karta koloniale, të cilat kanë qenë aktet me fuqi më të lartë juridike në nivel kolonish. Kur vendet ish-koloniale amerikane u pavarësuan, para se të themelonin **SHBA**-në, nisi kontrolli gjyqësor i kushtetutshmërisë, por tani duke marrë si bazë jo kartat koloniale, por kushtetutat e reja nacionale. Kjo përvojë u shndërrua në standard të vendosur mirë në kohën e themelimit të **SHBA**-së, ashtu që tani këtë detyrë e luante **GJSSHBA** kundrejt gjykatave supreme të shteteve anëtare dhe kundrejt çdo organi tjetër kushtetues.

Seksioni i katërt dhe i fundit flet për përhapjen e gjyqësisë kushtetuese në Evropë që nga koha në mes të dy luftërave botërore. Kalimthi flitet edhe për debatin teorik të kësaj kohe lidhur me atë se kush duhet të jetë gardian i supremacisë (epërsisë) së kushtetutës nacionale. Po ashtu, krejt kalimthi flasim edhe për tri fazat e përhapjes së gjyqësisë kushtetuese dhe arsyet për një gjë të tillë. Këtu në këto faza zihen në gojë edhe vendet tjera jashtë Evropës. Tërë ky diskutim i shpejtë në këtë kapitull bëhet me qëllim që lexuesit t'i ofrohet një mundësi për të kuptuar më lehtë kapitujt tjerë në vijim që flasin për gjyqësinë kushtetuese në vendet e ndryshme të Evropës dhe përtej, si dhe karakteristikat e tyre.

Dy seksionet e fundit i kushtohen komenteve dhe pyetjeve si dhe literaturës shtesë për lexuesin e devotshëm që synon thellimin e dijeve në lëmin e gjyqësisë kushtetuese. Këto dy seksione shoqërojnë çdo kapitull të këtij libri, siç e kemi sqaruar në hyrje.

2.1. Botëkuptimet mbi një rend superior, më të lartë: bota antike deri te kushtetutat e para të shkruara

Përgjatë historisë së shoqërive të organizuara në shtet kanë dominuar botëkuptimet sipas të cilave çdoherë ka ekzistuar një rend më superior, më i lartë, krahasuar me të tjerët.[1] Vënia në jetë dhe mbrojtja e këtij rendi më superior, më të lartë, ka krijuar konceptin e hierarkisë së burimeve të së drejtës dhe, për pasojë, ka lindur nevojën e pasjes së një mekanizmi institucional, hierarkik po ashtu, me qëllim të realizimit vetëm të një qëllimi: sigurimin e superioritetit (epërsisë) së rendit më superior, më të lartë, krahasuar me të tjerët.

Krijimi i mekanizmave institucionalë, të cilët kanë pasur për qëllim sigurimin e superioritetit (epërsisë) të rendit më superior, më të lartë, krahasuar me të tjerët ka qenë vija e përgjithshme dhe konstante në kuadër të së cilës duhet të kërkohet lindja e gjyqësisë moderne kushtetuese. Çdoherë në të kaluarën, në secilin rend, kanë ekzistuar mekanizma institucionalë që kanë qenë pjesë e hierarkisë së organeve publike, mirëpo qëllimi i tyre nuk ka qenë sigurimi i epërsisë (superioritetit) së një rendi më superior, më të lartë, krahasuar me tjerët. Për pasojë, organet e tilla, sado që kanë qenë mekanizma institucionalë, nuk mund të konsiderohen si organe (mekanizma institucionalë) të gjyqësisë kushtetuese. Me fjalë tjera, deri në kohën e marrjes së vendimit të parë në **Britani të Madhe**, i cili cilësohet si kontroll gjyqësor e që diskutohet në vijim, nuk ka ekzistuar një rend objektiv juridik brenda rendit shoqëror ku marrëdhëniet publike normohen përmes rregullave objektive. Në këtë kohë, kanë qenë rregullat etike, morale, tradita si dhe zhvillimet tjera të strukturave shpirtërore që kanë shërbyer si rregullator dhe kontrollues i marrëdhënieve publike. Në veçanti, Kisha e cilësdo proveniencë (katolike, protestante, ortodokse, etj.), ka pasur një ndikim të madh si kontrolluese etike, morale, tradicionale dhe shpirtërore e rendit shoqëror në përgjithësi.

Kontrolli gjyqësor, si pararendës i gjyqësisë kushtetuese, ka nisur shumë më vonë në **Britaninë e Madhe**, me rastin e vendimit të njohur si **Dr. Bonham** (1610), për të marrë "vulën e thatë" në **SHBA** me vendimin historik të cekur më lart **Marbury vs Madison**. Fakti se para kësaj kohe nuk ka ekzistuar një organ, përkatësisht një mekanizëm institucional që ka pasur për qëllim ruajtjen e supremacisë (epërsisë) së një rendi më superior, më të lartë, krahasuar me të tjerët shpjegohet me rrethanën se asnjëherë para fillimit të shekullit 17 nuk ka pasur një rend unik më superior që ka qenë më i lartë se të tjerët. Sikur të kishte ekzistuar më herët një rrethanë e tillë, domosdo që do të ishte shtruar nevoja e krijimit të një mekanizmi institucional për mbrojtjen e këtij rendi. Kjo, megjithatë, nuk do të thotë se në të kaluarën, nga **Antika** deri në fund të **Mesjetës**, nuk ka ekzistuar një hierarki e organeve të pushtetit publik. Këtë do ta shohim më vonë. Esenca e këtij dallimi qëndron në faktin se në periudhën e cekur më sipër nuk ka ekzistuar një botëkuptim i qartë dhe i kristalizuar për një rend unik të prekshëm që ka vlerë më superiore, më të lartë, kundrejt rendeve të tjera që operojnë në shoqëri. E shprehur me fjalë të tjera, ekzistimi i organeve të pushtetit publik me një vlerë superiore dhe më të lartë në krahasim me organe të tjera në të njëjtën shoqëri dhe në të njëjtën periudhë kohore, nuk do të thotë se kanë ekzistuar edhe mekanizma institucionalë për vënien në jetë të kësaj hierarkie të organeve.

[1] Lucio Pergoraro, *Giustizia costituzionale comparata. Dai modelli ai sistemi* (G. Giappichelli Editore – Torino,2015) fq. 15-20.

Ata mekanizma institucionalë që kanë ekzistuar në të kaluarën antike **greko-romake** e deri në mesjetën evropiane, duhen kuptuar në kontekst të kohës dhe asnjëherë si praktika moderne të kontrollit të legjitimitetit të ligjeve dhe akteve të tjera të autoriteteve publike. Ata nuk kanë qenë veçse prototipe, të cilat i ngjasojnë kontrollit kushtetues modern ashtu siç e njohim sot.[2] Përmes paraqitjes së zhvillimit të tyre, megjithatë, mund të kuptohet më mirë trashëgimia aktuale **greko-romake**, si dhe vetë esenca e kontrollit modern kushtetues. Ekzistimi i këtyre mekanizmave prototipa, të cilët vetëm sipërfaqësisht i ngjanin kontrollit modern kushtetues, nuk lidhet me formën e qeverisjes apo të sundimit në kohën **greko-romake** deri në periudhën e **Mesjetës**. Bëhet fjalë, në esencë, për prototipe që kanë pasur qëllim dhe natyrë tjetër, përkatësisht ndëshkimin penal për moszbatim të segmenteve të caktuara të së drejtës së kohës së tyre. Kjo nënkupton se këta mekanizma nuk kanë synuar dhe as nuk kanë pasur për qëllim ruajtjen e ndonjë superioriteti (epërsie) të një rendi superior, më të lartë se rendet tjera. Koncepti i fundit, pra ai i epërsisë (superioritetit) të një rendi shoqëror kundrejt rendeve të tjera, siç u tha më sipër, as që ka ekzistuar në këtë kohë, ani se kanë ekzistuar aty-këtu kushtetuta të shkruara (si p.sh. në disa prej qytet-shteteve greke).

Vënia në jetë dhe ruajtja e epërsisë (supremacisë) së një rendi më superior shoqëror, më të lartë krahasuar me të tjerët, nënkupton ekzistimin e një sistemi garancionesh kushtetuese, në kuptimin juridiko-teknik, gjë që në këtë kohë nuk ka mundur të ekzistojë. Fjala është, thënë shkurt, për një sistem të respektimit të normave që vlenin dhe që duheshin zbatuar në shoqëritë e organizuara në shtet në këtë periudhë të zhvillimit në **Antikë** (në Greqi dhe në Romë) deri në Mesjetë, pa ndonjë mekanizëm apo garancion institucional juridiko-teknik që siguron këtë superioritet (epërsi). Këto norma parashihnin instrumentet, të cilat synonin kontrollin e aktivitetit të organeve shtetërore, si p.sh. të mbretit, asamblesë apo të këshillave të ndryshëm, njëjtë siç kontrollohej çdo qytetar tjetër, me qëllim të caktimit të një përgjegjësie penale, pra jo me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së një rendi superior, më të lartë, krahasuar me tjerët.[3] Natyra juridike dhe qëllimi i këtyre normave dhe instrumenteve kontrolluese të aktivitetit të organeve shtetërore kanë qenë tërësisht penale.

Diskutimi i mekanizmave prototip si më sipër është i domosdoshëm sepse duhet të kuptohet se cila ka qenë natyra dhe fizionomia e tyre në të kaluarën. Jo vetëm kaq. Nga të kuptuarit e tyre sot, ne kuptojmë më lehtë vetë origjinën dhe trajektoren e zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese moderne, në veçanti zhvillimet përgjatë shekujve formativ të gjyqësisë kushtetuese - shekujt XVIII, XIX e deri në mesin e shekullit XX. Ky diskutim kaq i domosdoshëm fillon, krejt natyrshëm, me shtjellimet e filozofëve modernë, të cilët janë të parët që kanë shtjelluar natyrën dhe formën (fizionominë) e pushtetit publik në antikitet.

Ka qenë **Greqia** e lashtë ajo që ka qenë objekt shtjellimi doktrinar i filozofëve të ndryshëm modernë. Me pikë referimi Greqinë, ata janë përsiatur për të gjetur gjenezën e kontrollit kushtetues modern, për të kaluar më pastaj në **Mesjetë**. I pari ndër ta ka qenë mendimtari **Monteskije** (**Charles de Secondat baron de Montesquieu: 1689-1755**), i cili ka trajtuar gjerësisht prototipat që i ngjasojnë mekanizmave modern të kontrollit kushtetues dhe që i takojnë antikës greke. Duke u marrë kryesisht me fizionominë e tyre në të kaluarën, **Monteskije** ka vërejtur se pushteti legjislativ në **qytet-shtetet greke** nuk kishte të drejtën e ndalimit të pushtetit ekzekutiv, por vetëm të drejtën dhe autorizimin e kontrollit të mënyrës së ekzekutimit të ligjeve që i kishte nxjerrë vet. Tre mekanizma institucionalë, që kanë qenë objekt trajtimi doktrinar te ky autor, i kanë shërbyer këtij qëllimi: **cosnes** në Kretë, **eforati** në Spartë dhe **nomophylax** në **Athinë**[4].

---

[2] Antonello lo Calzo, i cilëson me të drejtë këto institute dhe këto praktika antike si protosisteme të gjyqësisë kushtetuese, përkatësisht të kontrollit kushtetues. Veçori e përbashkët e të gjithave është se ato nuk fokusohen në kontrollin kushtetues të normës, por në kontrollin e zbatimit të ligjeve në Greqinë dhe Romën antike. Vetëm më lindjen e kushtetutave të para të shkruara moderne në fund të shekullit XVIII fillon lindja dhe zhvillimi i kontrollit kushtetues dhe i gjyqësisë kushtetuese si veprimtari shtetërore e veçantë me qëllim të sigurimit të epërsisë së tekstit kushtetues krahasuar me çdo akt tjetër juridik. cf. Antonello lo Calzo, "PROTOSISTEMI DI GIUSTIZIA COSTITUZIONALE: IL CORPO DEGLI EFORI NELLA COSTITUZIONE DELLA REPUBBLICA NAPOLETANA DEL 1799"/ "EARLY SISTEMS OF CONSTITUTIONAL ADJUDICATION: THE COUNCIL OF THE EPHORS IN 1799 NEAPOLITAN REPUBLIC CONSTITUTION " *HISTORIA CONSTITUCIONAL* num. 14 (Septiembre, 2013) fq. 251-305 në fq. 255-256 (fusnotat 14 dhe 15).

[3] L. Mezzetti, M. Belletti, E D'Orlando & E. Ferioli, *LA GIUSTIZIA COSTITUZIONALE* (CEDAM: Padova, 2007) fq. 20.

[4] Montesquieu, *L'ESPRIT DES LOIS. SUIVI DE LA DEFENCE DE L'ESPRIT DES LOIS. LIVRE XI* (Belin – Leprieur, Libraire – Editeur: Paris, 1845), fq. 111.

I pari, **cosnes,** nuk diskutohet që nuk mund të konsiderohet si organ i kontrollit kushtetues. Ai ka qenë më tepër si një rregullator i autorizuar i jetës së **qytet-shtetit kretian**, si titullar i pushtetit suprem të popullit. Veprimi i **cosnes-**it në emër të popullit ndihmohej nga **Këshilli i Vjetërve**. Një organ tjetër, ndërkaq, shërbente si miratuese e veprimeve të tij: **Asambleja e Kretës** kishte të drejtën ekskluzive për të miratuar ose refuzuar propozimet e bëra nga ky Këshill. Çdo dështim për të bërë një propozim të mirë tërhiqte me vete një sanksion penal për propozuesin. Nga kjo shihet qartë se fizionomia e këtij organi nuk ngërthente në vete qëllimin e mbrojtjes së ndonjë rendi superior, më të lartë së të tjerët. Ky botëkuptim mbi rendin superior, më të lartë se të tjerët, nuk ka ekzistuar fare në këtë kohë.

I dyti, instituti i **eforat-**it, i lindur në **Spartën** e vjetër, ka qenë një organ mbikëqyrës. Në fakt, vetë fjala **efor** në gjuhën greke e ka kuptimin e mbikëqyrjes. Ai ka qenë një këshill i përbërë prej pesë vetëve që, në rend të parë, kishin për qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe, aty ku gjenin se ato nuk po zbatoheshin si duhet, mund të nisnin procedurat penale kundër qytetarëve. Ky organ kishte të drejtë të mbikëqyrte edhe punën e dy mbretërve spartanë, të cilët mund të dërgoheshin në përgjegjësi pranë **gerousia**, një lloj gjykate supreme e **Spartës**. Edhe në rastin e **eforat**-it nuk mund të flitet për kontroll kushtetues të superioritetit të (epërsisë) së ndonjë rendi të bazuar në një normë të lartë juridike, por për një kontroll të aktiviteteve individuale të zyrtarëve shtetërorë spartanë.[5]

Së fundi, në **Athinën** e vjetër kanë ekzistuar organe shumë të veçanta, të njohura me emra të ndryshëm, të cilat i shërbenin në mënyrë unike rendit të njohur si **nomos**.[6] Juristi dhe filozofi i mirënjohur i drejtësisë, gjermani **Karl Shmit** (**Carl Schmitt: 1888-1985**), me plot të drejtë e ka cilësuar **nomos**-in si rend dhe si orientim, pra shumë më shumë se kuptimi "ligj", i cili nganjëherë i atribuohet fjalës nomos.[7] Në këtë kontekst, me këtë term janë kuptuar disa gjëra në të njëjtën kohë: së pari, me të është kuptuar rendi më i lartë në Athinë; së dyti, ai ka qenë vetë baza e strukturës së tij; dhe, së treti, **nomos-**i ka personifikuar vetë parimet e përgjithshme të rendit shoqëror athinas. Për të siguruar pacenueshmërinë e këtyre cilësive nga qytetarët, përkatësisht me qëllim të vënies së këtyre kuptimeve në jetë nga të gjithë, athinasit kishin themeluar një rrjet mekanizmash institucionalë kontrollues, të cilët konstatonin nëse po cenohej **nomos-**i. Kjo në veçanti vinte në shprehje lidhur me aktivitetin e **Këshillin e Athinës**, i quajtur **boule**, që zgjidhej nga **Kuvendi i Popullit**, i quajtur **ecclesia.**

Në ndërkohë që **nomos-**i përbëhej nga të gjitha normat, parimet dhe strukturat fundamentale të shoqërisë së Athinës, të cilat integroheshin në kuptimin e tij, **psefisma-**t përbënin aktivitetin ligjvënës të **boule-**s në Athinë. Këto akte nganjëherë kishin natyrë të përgjegjshme. Si të tilla u ngjasonin akteve ligjore, por të cilat, megjithatë, në esencë ishin dekrete dhe çdoherë duhej të ishin në pajtim me **nomos-**in. Ndryshimi i këtij të fundit konsiderohej si mjaft i vështirë, gjë që nuk ishte rasti me të parat. Cilësia e ndryshimit me vështirësi të **nomos-**it e bënte atë si mëshirim i një rendi superior, më të lartë, se çdo rend tjetër që prodhohej apo personifikohej nga **boule**-i dhe aktiviteti i tij.

Ata që donin të nxirrnin **psefisma**, përmes të cilave rregullohej jeta e përditshme e grekëve dhe që kishin kuptimin e dekreteve të kohës moderne, duhej ta kishin të qartë se ato nuk guxonin të ishin kundër **nomos-**it grek. Thënë shkurt, **nomos-**i konsiderohej si një rend natyror, i pandryshueshëm, kurse **psefisma** konsiderohej si një e rend i gjërave që mund të ndryshonte më lehtë për arsye se me të rregullohej jeta e përditshme e athinasve. Nëse **psefism-**a binte ndesh me këtë postulat, pra nëse realizimi në praktikë i

---

5 Në kohën e modernitetit, efori si institut ishte paraparë për herë të fundit në Kushtetutën e Napolit të vitit 1799. Në kapitullin XIII të saj, të titulluar "Ruajtja e Kushtetutës" (nenet 350 – 380), Kushtetuta fliste për detyrat e ngjashme të *eforatit* napoletan. Shih më shumë për këtë në Vincenzo Cuoco, *Historical Essay on the Neapolitan Revolution of 1799* (University of Toronto Press: Toronto, 2014) fq. 178 – 181 (Kapitulli XLI: "Constitution – Other Laws").

6 Cf. Kurt A. Raaflaun, "Early Greece", kapitulli i 6-të, dhe David J. Philips, "Athenes, kapitulli i 7-të, botuar në Benjamin Isakhan and Stephen Stockwll (eds.), *The Edinburgh Companion to the History of Democracy. From Pre-Hsitory to Future Possibilities* (Edinburgh University Press: Edinburgh, 2015); Cf. lidhur me historikun e qytetet shteteve greke që nga momenti i themelimit deri me shkatërrimin e tyre, në S. E. Finer, *The History of Government. Vol. I.: Ancient Monarchies and Empires* (Oxford University Press: Oxford, 1999) fq. 316-384.

7 Carl Schmitt, *The Nomos of the Earth in the International Law of the Jus Publicum Eurpeaum* (Telos Press Publishin: USA, 2006), kapitulli 4: "On the Meaning of the Word Nomos" (fq. 67-79).

psefisma-s nuk vlerësohej si pozitiv, atëherë propozuesi i saj mund të kishte përgjegjësi penale. Përveç kësaj, **psefisma-**t që binin ndesh me **nomos-**in konsideroheshin të pavlefshme ashtu që edhe gjyqtarët grekë duhej të kishin kujdes **ex officio** që mos t'i zbatonin ato në praktikë. Krahas gjyqtarëve, në **Athinë** ka qenë edhe një organ tjetër i quajtur **nomophylax** (shumës: **nomophylakes**), i cili ka pasur pushtetin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve pozitive të **Athinës**.[8]

Tërë ky rrjet organesh ka pasur vetëm një qëllim, sigurimi i pacenueshmërisë së **nomos**it që mund të vinte kryesisht nga aktiviteti norma vënës dhe veprimet tjera të organeve të tjera që mund të ishin në kundërshtim me të. Përgjegjësia çdoherë ishte penale dhe nuk konsistonte në restaurimin e rendit të cenuar superior, më të lartë, i cili quhej **nomos**. Vetëm nga ky aspekt mund të thuhet se prototipi i **nomos-**it i ngjason botëkuptimeve moderne mbi një rend superior, më i lartë krahasuar me tjerët. Mekanizmat institucionalë, ndërkaq, kanë pasur për qëllim pengimin përmes ndëshkimit penal të çdo cenimi të rendit **nomos**. As që mund të flitet në këtë kohë për ndonjë garanci kushtetuese në kuptimin e sotëm të fjalës: *"e drejta kushtetuese"* greke zbatohej në mënyrë të njëjtë si çdo ligj tjetër, gjithnjë nën kërcënim të sanksionit penal, jo me qëllim të restaurimit të saj si një rend objektiv. Ai rend objektiv në kuptimin e sotëm të fjalës nuk ka ekzistuar në **Athinën** e lashtë.

Edhe në **Romë** ka ekzistuar një institucion kontrollues i të tjerëve, i njohur si **tribunët.** Këta ishin qytetarë të zgjedhur, të cilët kishin për detyrë të mbronin plebejtë nga shpërdorimi i ligjit dhe nga tirania e patricëve. Ky kontroll, që kishte për qëllim mbrojtjen, ka pasur natyrë klasore nisur nga fakti se ka pasur të bëjë vetëm mbrojtjen e shtresës së plebejve. Sikundër vërehet, përvoja romake nuk dallon në thelb nga ajo greke. Të dyja së bashku kanë shërbyer si burim inspirimi i dijetarëve modernë për të studiuar praktikat që u zhvilluan në Evropë në periudhën e Mesjetës. Ne këtu shkëpusim vetëm rastin e **Venedikut**, si një ekzemplar tipik i këtij inspirimi.

Përvoja praktike mesjetare ka qenë me relevancë në lëmin e origjinës së gjyqësisë kushtetuese. Kjo është arsyeja që në vijim japim përciptazi praktikën e **Venedikut**, për të kaluar pastaj në Antikë dhe kohën e kushtetutave të para të shkruara dhe ndikimin e tyre në ndërtimin e kontrollit kushtetues, ashtu siç e njohim sot. Krejt këto zhvillime nuk kanë shkuar pa një shtjellim doktrinar të dijetarëve të kohës. Shtjellimet doktrinare të mendimtarëve perëndimorë kanë vënë themelet e sigurta të individualizimit të kuptimeve dhe mekanizmave institucionalë për mbrojtjen e kushtetutës, të cilët kanë qenë të ngjashëm (prototip) me kuptimet dhe mekanizmat modernë të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve tjera juridike. Me kushtetutë këtu nënkuptohet tërësia e rregullave të lojës politike (pushtetit) që kanë ekzistuar në çdo kohë të zhvillimit të shoqërisë njerëzore.

Ndër mekanizmat institucionalë mesjetarë, që doktrina juridike e ka individualizuar si njërin prej prototipave (pararendësve) të rëndësishëm të gjyqësisë kushtetuese, bën pjesë institucioni venecian **Avogadori del Commun**, i krijuar më 864. Ky organ kolegjial kishte për detyrë primare mbrojtjen e interesave të aristokracisë veneciane nga organet e ndryshme të shtetit të **Venedikut**. Si i tillë, ky institucion kishte të drejtë të suspendonte (pezullonte) aktin juridik të qeverisë veneciane apo të ndonjë organi tjetër, përfshirë këtu **Dukën** (Ital.: **Il Doge**), udhëheqësin suprem civil dhe ushtarak të **Venedikut**, nëse konsideronte se akti binte ndesh me interesat e aristokracisë vendase. **Avogadori,** ngjashëm si **tribunët romakë**, të cilët mbronin plebejtë nga veprimet e patricëve, mbronin aristokracinë venedikase nga strukturat e pushtetit vendor. Këta të dytët, për dallim nga të parët, mund të suspendonin aktet juridike. I tërë fokusi i punës së tyre koncentrohej në vlerësimin nëse akti juridik i një pushteti të caktuar në **Venedik** cenonte të drejtat e aristokracisë vendase. Në këtë kuptim, **Avogadori** mund të thuhet që më së shumti i ngjasojnë kuptimit modern të mekanizmit institucional për kontrollin kushtetues të legjitimitetit të ligjeve dhe akteve të tjera juridike. Megjithatë, **Avogadori** nuk kanë pasur për synim sigurimin e supremacisë (epërsisë) së rendit objektiv të përcaktuar me kushtetutë, por ekskluzivisht për mbrojtjen e interesave të aristokracisë venedikase.

Sikundër shihet, botëkuptimi venecian lidhur me atë se çka konsiderohet rend superior, më i lartë, e çka rend inferior, më i ulët, ka qenë kuptimisht i njëjtë me botën greko-romake. Në fakt, tërë përpjekja e botës

[8] Susan Lape, *Reproducing Athens. Menander's Comedy, Democratic Culture, and the Helenistic City* (Princeton University Press: Princeton, 2004) fq. 48-50.

perëndimore, e cila ndjek traditën **greko-romake**, është fokusuar në krijimin e një rendi më superior, më të lartë se të tjerët, në mënyrë që ai mos të ndryshohet papritur e në çdo kohë dhe, me këtë, të ndërtohet siguria dhe qëndrueshmëria e kohezionit shoqëror. Kjo përbën vijën konstante të teorisë dhe praktikës mbi sundimin e ligjit ashtu siç e njohim sot.

Ideja fillestare mbi një rend superior, që është më i lartë se rendet tjera, ndër dijetarët antikë ka lindur mbi bazën e dallimeve në mes të asaj që është e përbotshme, dhe tjetrës që nuk i takon kësaj bote. Dallimi në mes të një rendi që është i përkohshëm (efemer), i bërë nga njeriu, dhe një rendi tjetër, i bërë nga hyjnitë (natyra), që është i përhershëm, ka ekzistuar te të gjithë mendimtarët **greko-romakë**, me fillim nga **Platoni** e deri te **Ciceroni**.[9] Ky botëkuptim ka qenë i njohur edhe në **Mesjetë**, diçka që bëhet e ditur nga shkrimet e mendimtarëve mesjetarë, pikëpamjet e të cilëve, siç mund të imagjinohet, kanë pasur një përmbajtje të theksuar teologjike (fetare) të proveniencës së krishterë. Nga autorët mesjetarë që më së shumti ka shtjelluar dallimin në mes të dy rendeve si më sipër, ka qenë **Shën Tomas Akuini** (**Sain Thomas Aquinas: 1225-1274**). Këtë autor e diskutojmë në vijim për arsye se pikëpamjet e tij më së miri shpërfaqin mesataren e mendimeve mesjetare lidhur me natyrën e rendit shoqëror të kohës dhe përfaqësojnë kontinuitetin e mendimit greko-romak lidhur me kuptimin e rendeve superiore, të larta, dhe të atyre që nuk kanë një cilësi të tillë.

Për **Shën Toma Akuinin** e drejta natyrore paraqiste një **lex superior** me rrënjë hyjnore, të cilës duhej t'i nënshtroheshin të gjitha normat dhe të gjitha subjektet. Kjo nënkuptonte që sovrani, Papa apo Perandori, duhej po ashtu t'i nënshtrohej të drejtës natyrore mbi të cilën mbështetej një rend më superior, më i lartë se rendi shoqëror i kohës. Nga kjo del se në **Mesjetë** ekzistonin dy rende: një ishte rendi **jus naturale**, i cili ishte më superior, më i lartë dhe më i pacenueshëm se rendi tjetër, **jus positivum**, i cili ishte inferior ndaj të parit dhe duhej t'i nënshtrohej atij. Ky dallim është ruajtur edhe te autorët e mëvonshëm të shekujve XVII dhe XVIII. Pas **Mesjetës**, megjithatë, ka pasur një ndryshim në botëkuptimin lidhur me atë se çfarë konsiderohej rend superior, më i lartë, e çka rend inferior, më i ulët. Me gjithë këtë ndryshim, edhe koha pas **Mesjetës** përbën një kontinuitet konceptual me mendimin greko-romak dhe përvojën e bazuar në të sa i përket ekzistimit të disa rendeve në shoqëri, njëri nga të cilët është superior dhe më i lartë se të tjerët që janë më inferiorë dhe më të ultë se tjerët. Ajo që ndryshon në këtë mes, qoftë në kuptimin teorik apo në atë praktik, ka të bëjë me bazën e arsyetimit të kësaj ideje dhe të përvojës së bazuar në të.

Gjatë shekujve XVII dhe XVIII ndryshoi baza (rrënja) e të drejtës natyrore dhe e rendit të bazuar në të: pas **Mesjetës** e drejta dhe rendi natyror bazoheshin në racionalizëm dhe laicitet. Sipas këtij botëkuptimi, njerëzit kishin të drejta natyrore, të lindura, të cilat ishin të paprekshme dhe të pacenueshme. Si të tilla, këto të drejta natyrore dhe rendi i bazuar në to shërbenin si kufizime për ligjvënësin post-mesjetar të shekujve XVII dhe XVIII. Ky botëkuptim, dhe rendi i bazuar në të, u shtjelluan deri në detaje nga **Xhon Loku** (**John Locke: 1632-1704**). Në veprën e tij monumentale **Dy traktate mbi qeverisjen** (1680-1690), Loku mbrojti fuqishëm **Revolucionin e Lavdishëm** (1688), i cili sanksionoi supremacinë (epërsinë) e parlamentit anglez kundrejt pushtetit absolut të kurorës. Sipas tij dhe botëkuptimeve dominuese të asaj kohe, çdo normë që ishte kundër **jus natyrale**, konsiderohej si e pavlefshme dhe e paqenë.

Në praktikë, megjithatë, gjendja ishte më ndryshe: gjyqtarët shpesh duhej të zbatonin normat e qarta të **jus positivum**, duke ua lënë filozofëve që të merreshin me formulimet e përgjithshme dhe të paqarta të **jus naturale**. Kjo shtroi nevojën e integrimit të këtyre dy të drejtave dhe të rendeve që bazoheshin në to, gjë që ndodhi më vonë, në kohët moderne, kur u krijuan mekanizma institucionalë përmes të cilëve u bë integrimi i tyre. Ky integrim nënkuptonte që e drejta natyrore e **Mesjetës** të shkrihet në të drejtën pozitive, e cila më nuk kishte burim hyjnor por ishte produkt i arsyes së ligjvënësit (mbretit dhe parlamentit) dhe i përpjekjeve laike të shoqërisë marrë si tërësi. Në literaturë kjo është quajtur në mënyrë lakonike "pozitivizm" i të drejtës natyrore, me të cilën dijetarët modernë kanë dashur të vënë në dukje anën racionale të sistemit të së drejtës natyrore.[10]

---

9 Mauro Cappelletti, *The Judicial Process in Comparative Perspective* (Clarendon Press: Oxford, 1989) fq. 122.

10 Mauro Cappelletti and William Cohen, *Comparative Constitutional Law. Cases and Materials* (The Bobbs-Merrill Company, Inc.: USA, 1979) fq. 7; Mauro Cappelletti, *The Judicial Process in Comparative Perspective*, fq. 123.

Ky ndryshim lidhur me burimin e të drejtës dhe rendin si tërësi domosdo që është reflektuar edhe në mënyrën e vënies në jetë të këtij ndryshimi. Hierarkia e re e burimit të së drejtës, i cili më nuk ishte hyjnor, si dhe e rendit të krijuar nga ky burim, domosdo që krijoi detyrime për gjyqtarët që me rastin e vënies në jetë të këtij ndryshimi, të bazoheshin në mekanizma të rinj institucionalë, në mesin e të cilëve ishte edhe interpretimi gjyqësor se cili rend ishte suprem, më i lartë se rendet e tjera. Kjo qasje e ndryshuar, qartë vërehet nëse analizohet origjina e kontrollit gjyqësor që u shfaq për herë të parë në **Angli** me rastin e cekur më lart **Dr. Bonham**. Në këtë rast, gjyqtari **Edvard Koke** (**Sir. Edward Coke: 1552-1634**), mbrojti supremacinë (epërsinë) e rendit të bazuar në të **drejtën e përgjithshme (common law)**. Kjo e drejtë kishte cilësitë e **jus naturale***,* kundrejt **jus positivum** që mishërohej në ligjvënien e parlamentit anglez. E drejta e dytë, që buronte nga parlamenti anglez, kishte shërbyer si bazë juridike për dënimin e **Dr. Bonham**. Duke e njohur epërsinë e **jus naturale** që mishërohej në të drejtën e përgjithshme, **Edvard Koke** ia mohoi mbretit anglez supremacinë (epërsinë) në ligjvënie. Me këtë, në mënyrë efektive, kryegjyqtari anglez tregoi se mbreti ishte sovran vetëm së bashku me parlamentin dhe se rendi i ndërtuar nga e **drejta e përgjithshme** nuk mund të shfuqizohej përmes **jus positive**. Ky hap pati për qëllim kufizimin e pushtetit të mbretit dhe, në këtë kontekst, duhet të shikohet, asnjëherë jashtë tij, kufizim që më vonë kulmoi me **Revolucionin e Lavdishëm**, i cili përfundimisht rrënjosi supremacinë (epërsinë) e parlamentit anglez. E thënë në mënyrë të thjeshtëzuar, në rastin **Dr. Bonham**, "e drejtë kushtetuese" u konsiderua vetëm ajo e drejtë që buronte nga natyra e shoqërisë angleze, e njohur si e **drejtë e përgjithshme**.

E vumë në thonjëza fjalën e drejta kushtetuese për shkak se në këtë kohë ende nuk bëhet fjalë për një të drejtë superiore, kohezive dhe që komandon superioritet (epërsi) absolute në kuptimin modern të kësaj fjale. Ka qenë nxjerrja e kushtetutave të shkruara, jo interpretimi gjyqësor, ai që ka nxitur dhe përshpejtuar nevojën për krijimin e mekanizmit të veçantë institucional për vënien në jetë të garancioneve kushtetuese të përmbledhura në një tekst. Për këtë u deshën gati dy shekuj nga rasti **Dr. Bonham**, për t'u miratuar tekstet e para kushtetuese, kushtetutat e para të shkruara, të cilat qartë sanksiononin një rend superior dhe më të lartë krahasuar me rendet tjera. Në luftën në mes të pushteteve qendrore për të ruajtur supremacinë (epërsinë) e një rendi të bazuar në kushtetutë kundrejt një tjetri rend që bazohej në ligje dhe burime të tjera, ka lindur koncepti modern i gjyqësisë kushtetuese, jo nga interpretimet gjyqësore të çastit, sado kreative që mund të kenë qenë ato (siç ishte rasti **Dr. Bonham**).[11] Kjo ndodhi në **SHBA**, siç do sqarohet më vonë, me rastin e theksuar më sipër **Marbury vs. Madison**, i cili legjitimoi dhe fuqizoi epërsinë (supremacinë) e Kushtetutës si qëllim parësor të secilit interpretim gjyqësor.

Para këtij viti, historik për gjyqësinë kushtetuese bashkëkohore, u patën krijuar të gjitha parakushtet për lindjen e kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë si një mekanizëm modern për kontrollin e legjitimitetit kushtetues të veprimeve (dhe mosveprimeve) dhe akteve juridike të pushtetit. Krijimi i këtyre kushteve lidhet me sundimin kolonial, i cili, në mënyrë paradoksale, në **Britani** bazohej në luftën për supremaci të së **drejtës së përgjithshme**, në ndërkohë që nëpër koloni mbronte supremacinë (epërsinë) e rendit pozitiv, i cili bazohej në të ashtuquajturat **charters**. Këto karta kishin statusin e aktit më të lartë juridik nëpër kolonitë britanike ("kushtetutat" e kolonive), mirëpo rendi pozitiv kolonial i bazuar në to nuk guxonte të binte ndesh me të **drejtën e përgjithshme** britanike. E thënë me fjalë të tjera, e drejta dhe rendi pozitiv në kolonitë amerikane që bazoheshin në **charters** ("kushtetutat") të kolonive, detyrimisht duhej të ishin në pajtim me të **drejtën e përgjithshme** dhe rendin kolonial britanik. Kjo gjendje ka krijuar, siç do të sqarohet në vijim, një situatë paradoksale, e cila, megjithatë, i bëri mirë teorisë dhe praktikës së kontrollit

---

[11] Cf. poashtu edhe Miodrag Jovicic, *Veliki ustavni sistemi. Elementi za jedno uporedno sutavno pravo* (IRO "Svetozar Markovic: Beograd, 1984) fq.417- 422 (në këtë libër, i cili ka të bëjë me krahasimin e sistemeve kushtetuese në **Britani të Madhe, ish-BRSS, Francë, Indi, Kinë, SHBA dhe Zvicër**, autori e vë fokusin në sigurimin e supremacisë së kushtetutës si shkakun kryesor për lindjen e gjyqësisë kushtetuese ashtu siç e njohim sot. Përveç kësaj, autori flet edhe për ndarjen e pushteteve si shkak i krijimit të gjyqësisë kushtetuese në vendet e proveniencës borgjeze, siç cilësoheshin atëherë vendet e demokracive kushtetuese liberale; autori tutje dallon sistemin institucional të kontrollit të kushtetutshmërisë nga sistemi i kontrollit të kushtetutshmërisë ku nuk ekziston një institucion i ngarkuar me një barrë të tillë, pa bërë dallimin në mes të modelit amerikan dhe atij evropian/kontinental dhe derivative të tyre; sistemin ku nuk ekziston një organ i ngarkuar me kontrollin e kushtetutshmërisë, ku hyjnë vendet si **Franca** pas vitit 1789 deri në formimin e **Këshillit Kushtetues (KKFr)**, pastaj vendet ish-komuniste dhe kështu me radhë, autori e cilëson si **sistem platonik**; ky cilësim bazohet në faktin se në këto vende nuk ka garancione kushtetuese që ligjet dhe aktet tjera më të ulëta se ligji do jenë në pajtim me kushtetutën, gjë që në praktikë nënkupton mohim të kushtetutës dhe supremacisë së saj sepse çdo gjë ngelet në mëshirën e fatit).

të legjitimitetit kushtetues të ligjeve që u ndërtua me vrull në rastin e sipër cekur të Gjykatës Supreme, rasti **Marbury vs. Madison**. Ky rast përfundimisht sanksionoi epërsinë e tekstit nacional kushtetues, tekstin e Kushtetutës së SHBA-së të vitit 1789 dhe rendin që bazohej në te, kundrejt çdo rendi tjetër që ekzistonte nëpër shtetet anëtare, ish-kolonitë britanike. Më shumë për këtë do të flitet sërish më vonë, pra në vijim.

E njëjta gjë, siç e pamë, nuk ndodhi në Britani me rastin **Dr. Bonham**. Arsye për këtë ishte se në Britani nuk pati një tekst kushtetues koherent, të qartë dhe të saktë që do të mund të interpretohej lehtë nga një mekanizëm gjyqësor. Rendi i bazuar në të **drejtën e përgjithshme** ishte një rend i turbullt, i paqartë dhe jo shumë i saktë, i cili ishte krijuar përgjatë shekujve mesjetarë të zhvillimit të gjyqësisë britanike. Për pasojë, kryegjyqtari Koke nuk mund të kishte për qëllim sigurimin e ndonjë supremacie (epërsie) të së **drejtës së përgjithshme**. Ai pati për qëllim, në rend të parë, mohimin e sundimit në Britani të mbretërve të dinastisë **Tudor**, të cilët cilësoheshin si ligjvënës përmes parlamentit britanik. Duke thënë se e drejta e përgjithshme (common law) kishte epërsi ndaj ligjeve të parlamentit, **Edvard Koke** mohoi aktivitetin ligjvënës të parlamentit për aq sa ai identifikohej dhe ishte një me pushtetin e monarkut të dinastisë **Tudor**. Kjo qasje, megjithatë, nuk nënkuptonte mohimin e supremacisë (epërsisë) së parlamentit në kuadër të sistemit kushtetues britanik, por vetëm mohimin e pushtetit të ligjvënies mbretërore që ushtrohej përmes institucionit të parlamentit. Me fjalë të tjera, këtu fjala ka qenë për kufizimin e pushtetit mbretëror dhe jo për themelimin e një mekanizmi që do të bënte kontrollin e legjitimitetit kushtetues të ligjeve britanike, përmes përdorimit të së drejtës së përgjithshme si parametër vlerësues për qëllimet e kufizimit të së drejtës së pushtetit absolut të mbretërve britanikë të dinastisë **Tudor**.

2.2. Revolucioni Francez dhe kontrolli kushtetues

Refuzimi fillestar nga aktorët e **Revolucionit Francez** për t'ia njohur gjyqësorit ndonjë rol në vënien në jetë të rendit të ri revolucionar nuk zgjati shumë. Mekanizmi institucional për ruajtjen e epërsisë së rendit të ri revolucionar në fillim ishte politik, mirëpo, me kalimin e kohës, ai u transformua në një mekanizëm gjyqësor pak a shumë të ngjashëm me vendet tjera evropiane. Kjo është arsyeja pse ekzistojnë dy faza në zhvillimin e kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë së rendit të ri postrevolucionar, faza politike dhe faza jopolitike.

Ky refuzim i futjes në sistemin nacional francez të institucionit të kontrollit gjyqësor të legjitimitetit kushtetues të ligjeve ka qenë pasojë e historisë së hidhur me rolin e gjykatave të larta përgjatë **ancien regime** (regjimit të vjetër). Gjykatat e larta franceze, të njohura me një emër të çuditshëm, **Parlements**, në kohën para Revolucionit të viti 1789 konsideroheshin si profesione që ushtronin një lloj kontrolli ndaj aktivitetit ligjvënës të mbretit. Si të tilla, ato gëzonin të drejtë që të refuzonin regjistrimin e ligjeve dhe dekreteve mbretërore nëse konsideronin se binin ndesh me ligjin fundamental.[12]Këto gjykata, megjithatë, kanë shpërdorur gjerësisht pushtetin e dhënë, deri në atë masë sa kanë kompromet uar rolin e tyre si kontrollues të pushtetit mbretëror, duke u kthyer në abuzues të pushtetit. Kjo, në mënyrë krejt të natyrshme, i është përshtatur rrethanës së njohur të kohës sipas së cilës gjyqtarët vinin nga radhët e aristokracisë vendore, ku mandati i gjyqtarit mund shitej dhe blihej sikur çdo send apo e drejtë tjetër. Me **Revolucionin Francez** kjo praktikë ndryshoi. Kjo për faktin se ndarja e pushtetit, si parim i ri i organizimit politik, nuk duronte më që ai të konsiderohej nga askush tjetër pos nga vullneti i sovranit, vullnet që e ushtronte përmes përfaqësuesve të vet në parlament. Kishte kaluar koha e origjinës hyjnore të pushtetit dhe e pandashmërisë së tij.

Një situatë e tillë ka shkaktuar kundërshtime të fuqishme mes dijetarëve të kohës, **Zhan Zhak Rusosë** (**Jean-Jacques Rousseau: 1712-1778**) dhe **Monteskijesë**. Idetë mbi ndarjen e pushteteve dhe mbi rolin zero të gjyqësorit në këtë mes ishin baza e **Revolucionit Francez**. Këto ide janë shprehur në veprat e këtyre dy dijetarëve. Këta e shihnin gjyqtarin si një zbatues mekanik të ligjit, pa asnjë kreativitet apo liri për interpretim të tyre. Ai thjeshtë duhej të shërbente si një **bouche de la loi**, gojë e verbër e ligjit, asgjë

[12] Ky institucion i gjykatave të larta, përmes të cilave deri diku kontrollohej pushteti mbretëror, quhej **remonstrance**. Cf. Yuhniëo Ngenge, "International Influences and the Design of Judicial Review Institutions in Francophone Africa" *American Journal of Comparative Law* Vol. 61 No. 2 (Spring 2013) fq. 433-460 në. fq. 436.

më shumë. Në praktikë, implementimi i kësaj ideje, idesë që nuk i njihte gjyqtarit asnjë të drejtë për interpretim të normës, në të njëjtën kohë nënkuptonte se kontrolli i legjitimitetit kushtetues të normave as që mund të vinte në shprehje. Në fakt, bazuar në idenë si më sipër, gjyqtarët dhe gjyqësori në **Francën** e pas vitit 1789, nuk konsideroheshin si pushtet, por si shërbim civil apo burokraci e thjeshtë. Kjo po ashtu nënkuptonte se edhe vendimet e tyre duhej të merreshin si diçka me vlerë dhe efekt vetëm sa i përket rastit apo mosmarrëveshjes konkrete, pa asnjë efekt apo vlerë tjetër praktike për të ardhmen. Një situatë si kjo pati për rrjedhojë faktin tjetër, sipas të cilit **precedenti** u zhduk në tërësi nga rendi francez. Kjo teori dhe kjo praktikë u përhap më pastaj në Evropë përmes pushtimeve të Napoleonit (**Napoleon Bonoparte: 1769-1821**).[13]

Kjo gjendje, megjithatë, u bë e paqëndrueshme sepse çdoherë e më shumë po ndihej nevoja për një kontroll të legjitimitetit kushtetues të ligjeve të parlamentit të ri francez. I kompromet uar gjatë kohës së regjimit të vjetër mbretëror (**ancien regime**), gjyqësori nuk përbënte më një opsion serioz për kryerjen e kësaj detyre të rëndësishme. Kjo domosdo shtronte nevojën e gjetjes së një mekanizmi tjetër institucional që do ta kryente kontrollin e legjitimitetit kushtetues të ligjeve të reja. Rruga e zgjedhur dhe mekanizmi institucional që do të kryente këtë detyrë, kësaj radhe nuk kërkohej brenda gjyqësorit francez, por brenda politikës. Një rrugë si kjo vinte si rezultat i kompromet imit të thellë gjyqësorit në të kaluarën, që i kishte shërbyer verbërisht kurorës. Mekanizmi i ri institucional u quajt **Tribunal de Cassation** (Tribunali i Kasacionit, më tej shkurt **TK**), i themeluar në vitin 1790.

Synim i këtij organi të ri ishte që të shërbejë si një lloj filtruesi i kushtetutshmërisë së ligjeve të reja, duke mos lejuar gjyqësorin të luante asnjë rol në interpretimin e tyre. Nëse shtrohej nevoja e një interpretimi, atëherë parashihej detyrimi për gjyqtarët që ligjet t'i dërgonin në parlamentin francez për interpretim përmes institucionit të sapoformuar të **TK**-së. Si pjesë e kësaj lufte për pengim të rikthimit në skenë të rolit të fuqishëm të gjyqtarëve ka qenë edhe aktiviteti i njohur shtetëror që përmblidhet me termin e institutit tanimë të njohur si **kodifikim**. Ideator i këtij aktiviteti që prodhoi institutin e kodifikimit, ka qenë perandori Napoleon. Meqë gjyqtarët duhej të shërbenin vetëm si zbatues mekanik të ligjit, vetë goja e tij, atëherë fuqishëm besohej se parlamenti, si përfaqësues i sovranit, duhej ta kodifikonte në tërësi çdo lëmi të drejtësisë në mënyrë që mos t'i lihej asnjë hapësirë interpretimit gjyqësor. E thënë me fjalë të tjera, në atë kohë kur u ndërmorën kodifikimet e mëdha napoleonike, u besua se më nuk do të ketë asnjë rrezik nga sundimi i gjyqtarëve: kodifikimi i kryer përjashtonte çdo mundësi për abuzim sepse çdo situatë jetësore ishte e futur në kodet e reja dhe nuk kishte nevojë të interpretohej nga askush.

Me kalimin e kohës, megjithatë, u pa se kodifikimet në fjalë po ashtu kishin nevojë për interpretim. Kjo bëri të lejohej që gjyqtarët të bënin interpretimin e kodeve të **Napoleonit**, rrethanë e cila në fund të shekullit XIX pati për pasojë transformimin e kuptimit të kasacionit në Francë: nga një organ politik, i themeluar me qëllim të kontrollit politik të legjitimitetit kushtetues të ligjeve, ai u shndërrua në një organ gjyqësor, i cili sot e kësaj dite është i tillë dhe njihet me emrin e organit që kryen kasacionin **Cour de Cassation** (**GJKFr**). Kjo gjykatë, tani e tutje kishte në ngarkesë të saj vetëm kontrollin e interpretimit përfundimtar të ligjit, të cilin e kishin bërë gjykatat e ulëta franceze. Edhe sot e kësaj dite nuk e ka në mandat të saj kontrollin e kushtetutshmërisë së veprimit legjislativ të shtetit, por vetëm kontrollin e mënyrës së zbatimit të ligjeve nga ana e gjykatave të ulëta në **Francë**. Kjo përvojë, historikisht shikuar, ka lindur për dy arsye: e para, si pasojë e praktikës franceze të supremacisë (epërsisë) së parlamentit që u proklamua pas Revolucionit; dhe, e dyta, si pasojë e kompromet imit të rolit të gjyqtarëve gjatë regjimit të vjetër (**ancien regime**). Për të adresuar këtë problematikë, me kalimin e kohës në Francë u zhvillua një praktikë tjetër e mbikëqyrjes së veprimit ekzekutiv dhe legjislativ të shtetit francez, që do ta diskutojmë në vijim.

Praktika e kontrollit kushtetues të veprimeve administrative dhe legjislative të shtetit ka nisur me themelimin e dy organeve të tjera të reja: **Kwshilli Shtetwror** (**KSHFr**) dhe **Këshilli Kushtetues**, (**KKFr**). Qëllimet e themelimit të këtyre organeve kanë qenë të ndryshme: **KSHFr** kishte për qëllim

[13] Herman Schwartz, *The Struggle for Constitutional Justice in Post-Communist Europe* (The University of Chicago Press: Chicago, 2000), fq. 14.

mbrojtjen e lirive kushtetuese të individëve të prekur nga veprimi administrativ i shtetit, kurse **KKFr** ka pasur për qëllim mbrojtjen e ekzekutivit francez nga fuqia ligjvënëse e parlamentit. Organi i parë ngeli organ i pastër gjyqësor në sferën e çështjeve administrative, kurse i dyti ngeli një institucion politik.

Me kalimin e kohës nevoja për kontroll kushtetues të veprimit, mosveprimit dhe aktive të tjera të shtetit bëri që këto dy organe të ndeshen në një pikë të përbashkët: mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të garantuara kushtetuese. Një evoluim i tillë kulmoi në prill të vitit 2010, kur **KKFr** fitoi të drejtën për kontroll represiv të ligjeve gjatë vendosjes për ndonjë çështje konkrete para gjykatave franceze a të tjera, që ky organ tani e tutje gëzonte të drejtën e vlerësimit nëse ligjet që duhen zbatuar në një rast apo mosmarrëveshje konkrete cenojnë liritë dhe të drejtat kushtetuese. Deri atëherë, KKF kishte pasur vetëm të drejtën e kontrollit preventiv të ligjeve, pas votimit në parlament dhe para hyrjes në fuqi. Ky institut i ri, i njohur si **kontrolli represiv i kushtetutshmërisë së ligjeve**, ka qenë diçka e panjohur për sistemin francez të kontrollit të kushtetutshmërisë. Në gjuhën franceze, procedura e kontrollit represiv të ligjeve emërtohet si **question prioritaire** ***de constitutionnalité (kërkesa për kontroll prioritar të kushtetutshmërisë së ligjit****), e njohur ndryshe sipas akronimit francez si* ***QPC***.[14]

Për llojet e kontrollit kushtetues në botën e sotme do të flasim më vonë në kapitujt tjerë. Tani, t'i kthehemi çështjes së evoluimit të kompetencave të dy institucioneve të cekura më lart.

I formuar fillimisht si organ këshillues i shefit të shtetit, **KSHFr** që nga 1780 mori kompetenca gjyqësore të kontrollit të veprimit administrativ të shtetit në rastet kur duhej mbrojtur liria dhe e drejta e individit. Në rastin e njohur si **Blanco** (1873), **KSHFr** konfirmoi se shteti ishte përgjegjës për dëmet e shkaktuara ndaj individëve nga ana e organeve shtetërore apo personave të punësuar në shtet. Kjo gjendje zgjati deri në fund të shekullit të 19-të. Shekulli në vijim pati ndryshime rrënjësore në fizionominë e këtij organi sepse u vendosen parime e standarde të reja në fushën e kontrollit kushtetues të vendimeve administrative, ndalimin e dekreteve **ex post facto**, promovimin e lirisë së ndërgjegjes dhe barazisë para ligjit. Ky ndryshim u bë jo duke u bazuar në tekstin kushtetues francez, por në "traditat republikane" përmes të cilave u bë i mundur efekti imediat i kontrollit të kushtetutshmërisë së veprimit administrativ të shtetit francez. Me "traditë republikane" u nënkuptua, atëherë dhe sot, fryma dhe germa e **Deklaratës mbi të Drejtat e Liritë e Njeriut dhe të Qytetarit** (1789) dhe **Preambula e Kushtetutës së Francës** (1946). Duhet theksuar se ky kontroll i legjitimitetit kushtetues të veprimit administrativ të shtetit kufizohej vetëm në vendimin konkret individual, pra jo edhe në legjislacionin bazë që ka shërbyer si bazë juridike për marrjen e vendimit konkret administrativ në një rast individual. Legjislacioni bazik ngelej në fuqi: shfuqizohej vetëm vendimi konkret administrativ i dhënë në një rast individual kurse qytetarit i takonte e drejta e zhdëmtimit si pasojë e dëmit eventual të shkaktuar me një vendim të tillë administrativ antikushtetues.

Mundësia e **KSHFr** për të bërë kontrollin kushtetues edhe të akteve juridike lindi vetëm pas nxjerrjes së Kushtetutës së vitit 1958. Kjo kushtetutë në nenet e saj 37 dhe 38 lejonte nxjerrjen e akteve juridike me karakter legjislativ nga ana e ekzekutivit francez. Kjo nënkuptonte që, tani e tutje, mund të bëhej edhe vlerësimi i kushtetutshmërisë së këtij aktiviteti legjislativ të ekzekutivit francez. Një mundësi e tillë u bë e ditur në rastin e njohur **Syndicat General** (1959). Në këtë rast, i cili kishte të bënte me një rregullore qeveritare që u jepte arkitektëve të drejtën ekskluzive për kryerjen e punëve të caktuara profesionale në kolonitë franceze, **KSHFr** theksoi se ishte e domosdoshme që ai të përcaktonte kufijtë e pushtetit rregullativ të ekzekutivit francez, si dhe caqet e kontrollit gjyqësor të këtij pushteti. Si bazë kushtetuese për kontrollin e kushtetutshmërisë së këtyre akteve rregullative shërbenin parimet e përgjithshme të së drejtës të inkorporuara në Deklaratën e vitit 1798 dhe parimet e përmbajtura në Preambulën e Kushtetutës së vitit 1958.

Organi tjetër, **KKFr**, po ashtu pati evoluim të madh në pasurimin e kompetencave të veta. Qëllim krye-

[14] Marie-Luce Paris, "Europeanization and Constitutionalization: The Challenging Impact of a Double Transformative Process on French Law." *YEARBOOK OF EUROPEAN LAW* No. 29/2010 (Clarendon Press: Oxford, 2010) fq. 21-64; Kemal GÖZLER, "La question de la hierarchie entre les normes constitutionnelles". *Annales de le Faculté de droit d'İstanbul,* Vol. XXXII, No.48, 1998, fq. 65-92.

sor i tij ka qenë të ndihmonte ekzekutivin e ri, të kryesuar nga gjenerali **De Gol** (**Charles de Gaulle: 1890-1970**), në ushtrimin e kompetencave ligjvënëse të fituara mbi bazën e Kushtetutës së vitit 1958. Si organ politik, **KKFr** ka pasur për juridiksion primar sigurimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollin kushtetues të aktivitetit ligjvënës të parlamentit francez. Ky juridiksion, i njohur për herë të parë nga viti 1958, është dhënë me qëllim të mbrojtjes së ekzekutivit *vis-a-vis* ligjvënësit francez. Në traditën e saj specifike të supremacisë (epërsisë) parlamentare, deri në vitin 1958, **Franca** ka pasur organe politike brenda ligjvënësit, të cilat kanë pasur për detyrë vlerësimin e kushtetutshmërisë së draftligjeve para se ato të votoheshin. Ky kontroll preventiv nuk prodhonte asnjë detyrim për ligjvënësin, gjë që nënkuptonte se ai mund t'i merrte parasysh vlerësimet politike të kushtetutshmërisë së një draftligji vetëm nëse një gjë e tillë i shkonte për shtati.

Kjo gjendje ka ndryshuar në vitin 1958. Tani e tutje, Kushtetuta e vitit 1958, me të cilën u themelua **KKFr**, e njohu të drejtën e kontrollit preventiv (paraprak) të kushtetutshmërisë së ligjeve. Me kontroll të tillë nënkuptohej e drejta e **KKFr** për të shpallur si jokushtetues një draftligj të votuar në parlament, por që akoma nuk ka hyrë në fuqi. Një kontroll i tillë bëhej vetëm ndaj ligjeve të një lëmi të caktuar, përkatësisht vetëm ndaj ligjeve që rregullonin ndarjen e pushtetit në mes të ligjvënësit dhe ekzekutivit. Kjo përcaktohej shprehimisht në nenet 34, 37 dhe 38 të Kushtetutës së vitit 1958, të cilat i jepnin ekzekutivit të drejta të mëdha ligjvënëse kundrejt parlamentit francez. Me qëllim të ruajtjes së këtij balanci të ri të krijuar në sferën e ligjvënies, **KKFr** u ngarkua me detyrën e mbikëqyrjes së legjislativit dhe garantimit se parlamenti francez nuk do të lejohej të ndërhynte në ushtrimin e autorizimeve të reja kushtetuese të ekzekutivit.

Kompetencat e **KKFr** u zgjeruan më 1971, në rastin e njohur si **liria e asocimit**. Me këtë rast, ky organ gjeti se kishte të drejtën e kontrollit kushtetues të ligjeve franceze, jo vetëm kur flitej për ndarjen e pushteteve, por edhe kur ligjet cenonin të drejtat dhe liritë e francezëve. Vendimi u mor sërish duke u bazuar në norma që nuk gjendeshin në tekstin e Kushtetutës së vitit 1958. Një gjë e tillë u arrit përmes interpretimit ndryshe të teksteve të mëhershme kushtetuese, tekste që doktrina i quajti **blloku i kushtetutshmërisë** (**bloc de constitutionalite**). Në këtë grup hyjnë: Deklarata e vitit 1789, preambulat e kushtetutave të vitit 1946 dhe 1958, parimet e njohura nga ligjet e Republikës dhe, së fundi, parimet e domosdoshme të kohës së sotme. Grupit të fundit i takojnë, **inter alia**, barazia para ligjit, liria e asocimit, barazia gjinore, e kështu me radhë.[15]

Vendimi i vitit 1971 dhe parimet e mishëruara me atë rast u kristalizuan shumë me kalimin e kohës, aq sa askush asnjëherë nuk i vuri në pyetje. Parimet fare nuk figurojnë në asnjërën prej kushtetutave franceze, përfshirë Kushtetutën e vitit 1958. I një natyre të tillë ka qenë edhe parimi i lirisë së asociimit, i cili shërbeu si bazë për marrjen e vendimit të vitit 1971, një vendim mjaft i favorshëm për shoqatat (e paregjistruara) jofitimprurëse. Me këtë vendim u shpall jokushtetues një ligj francez i vitit 1971 që kërkonte regjistrimin si kusht për veprim të shoqatave jofitimprurëse. Tani e tutje, në emër të lirisë së asociimit, shoqatat jofitimprurëse mund të operonin në **Francë**, pa pasur asnjë nevojë që të regjistroheshin.Në vijim si më sipër, zgjerimi i juridiksionit të **KKFr** më 2010 qe aq i madh sa e bëri atë gati një organ gjysmë gjyqësor. Këtë herë, si bazë shërbeu një akt juridik jofrancez dhe të drejtat e liritë njerëzore të njohura nga ai. E kemi fjalën për **Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut** (**KEDNJ**). Njëjtë siç kishte ndodhur me **Britaninë e Madhe** më 1998, kur u miratua **Ligji për të Drejtat e Njeriut** (**Human Rights Act**), Franca po ashtu u detyrua ta ndryshojë legjislacionin e brendshëm me të cilin përcaktohet vendi dhe rëndësia e **KEDNJ-së** në rendin e saj kushtetues. Tani, me këtë ndryshim, **KKFr** mandatohet për të kryer kontrollin e kushtetutshmërisë së legjislacionit francez në fuqi me qëllim të vlerësimit nëse ai legjislacion është në pajtim me liritë dhe të drejtat e njeriut të garantuara me **bllokun e kushtetutshmërisë.** Në këtë bllok përfshihet, në mënyrë efektive, **KEDNJ-ja.** Kjo do të thotë se gjykatat franceze me rastin

[15] Marie - Claire Ponthoreau and Fabrice Hourquebie, "France: The French Conseil Constitutionel: An Evolving Form of Constitutional Justice". Në Andrew Harding and Peter Leyland (eds.), *Constitutional Courts. A Comparative Study* (Wildy, Simmonds & Hill Publishing: London, 2009) fq. 81-101; Marie - Claire Ponthoreau and Jacques Ziller, "The Experience of the French Conseil Constitutionel: Political and Social Context and Current Legal-Theoretical Debates". Në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West. Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post – Communist Europe in a Comparative Perspective* (Kluwer Law International: The Hague, 2010) fq. 119-142.

e vendosjes për rastet dhe mosmarrëveshjet konkrete të shtruara për zgjidhje pranë tyre, tani e tutje, kanë për detyrë të shikojnë nëse ligji francez, apo ndonjë akt tjetër nënligjor, cenon ndonjërën prej të drejtave dhe lirive individuale të garantuara me **bllokun e kushtetutshmërisë**, në të cilin hyn edhe **KEDNJ-ja.**

Nga kjo që u theksua më sipër, shihen qartë dy ndryshime të mëdha të cilat kanë ndodhur dhe që më herët nuk kanë ekzistuar në rendin kushtetues francez. E para, **KKFr** tani e tutje e kryen edhe kontrollin kushtetues të ligjeve në fuqi, pra të atyre ligjeve që kanë hyrë në fuqi dhe aktualisht zbatohen. Ky njihet si **kontroll represiv** i legjitimitetit kushtetues të ligjeve. E dyta, ky kontroll nuk kufizohet vetëm në analizimin nëse ligji francez cenon të drejtat e ekzekutivit, por edhe nëse ai cenon liritë dhe të drejtat themelore të individit, ashtu siç janë interpretuar këto liri dhe të drejta nga ana e **KKFr** me vendimet e veta të mëparshme. Si bazë për këtë vendimmarrje shërben **blloku i kushtetutshmërisë**, në të cilin bën pjesë edhe **KEDNJ-ja.**

Me këtë, **KKFr** ka marrë funksionin gjyqësor të gardianit të lirive dhe të drejtave themelore të individit kundër cenimeve të tyre eventuale nga ligjet e parlamentit francez dhe nga akterët tjerë të rendit kushtetues. Duhet theksuar se, megjithatë, për dallim nga sistemi amerikan, gjykatat e ulëta franceze, të cilat kanë mandat për ta referuar çështje në **KKFr** për **QPC**, nuk kanë të drejtë të kryejnë vlerësimin e legjitimitetit kushtetues të ligjit apo ta mënjanojnë zbatimin e të njëjtit. **Franca** ngelet, në këtë kuptim, në vendet me **model kelsenian/evropian** të kontrollit të centralizuar të kushtetutshmërisë. Në këtë sistem, gjyqësori i rregullt nuk gëzon të drejtën për shmangie nga zbatimi i përhershëm i normës juridike që duhet të zbatohet ndaj një rasti apo mosmarrëveshjeje konkrete. Kur dyshon në kushtetutshmërinë e normës, gjyqtari i rregullt e ka vetëm të drejtën e referimit të çështjes që gjendet para tij në **KKFr**. Ky referim nuk bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë por me ndërmjetësimin e gjykatave më të larta në vend. E thënë me fjalë të tjera, gjyqësori i rregullt nuk mund të ushtrojë vlerësimin përfundimtar të kushtetutshmërisë së normës në rastet kur dyshon në kushtetutshmërinë e saj; një gjë e tillë i takon vetëm **KKFr**, i cili këtë e bën përmes referimit të çështjes nga ana e gjykatave më të larta në vend.

Në një rast të tillë, jo vetëm në **Francë**, por edhe në sistemet tjera të kontrollit të centralizuar të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjera, gjykata referuese ia referon aktin me normën juridike për kontroll kushtetues Gjykatës Kushtetuese nacionale, duke e pritur derisa kjo gjykatë ta thotë fjalën e fundit në mënyrë autoritare dhe përfundimtare lidhur me kushtetutshmërinë e aktit me normën juridike, e cila duhet të zbatohet në një rast apo mosmarrëveshje konkrete pranë një gjykate të rregullt. Referimi mund të jetë direkt, ku çdo gjykatë e rregullt ka të drejtë të referojë çështje në gjykatë kushtetuese, apo i tërthortë, kur ky referim mund të bëhet vetëm përmes gjykatave më të larta në sistemin e gjyqësisë së rregullt (gjykatat supreme apo më të larta të cilitdo juridiksion). **KKFr** hyn në kategorinë e dytë të sistemeve të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjera juridike (kontrolli abstrakt i kushtetutshmërisë së normave juridike).

2.3. Pavarësia e SHBA-së dhe kontrolli gjyqësor

I ashtuquajturi **Revolucioni Madhështor i Anglisë** e ndërpreu edhe atë pak praktikë gjyqësore që kishte nisur me rastin **Dr. Bonham**. Në fillim u duk sikur **Anglia** do të jetë djepi i kontrollit gjyqësor të legjitimitetit kushtetues të ligjeve dhe akteve të tjera juridike. Kjo, megjithatë, nuk ndodhi: në vitin 1688, revolucionarët anglezë shpallën epërsinë absolute të parlamentit anglez. Një hap i tillë nënkuptonte se, për pasojë, **jus positivum** që prodhohej nga parlamenti ishte e barasvlershme me vullnetin e sovranit, popullit e jo mbretit.

Kjo në praktikë përkthehej ashtu që gjyqtarët nuk mund të bënin asnjë kontroll të kushtetutshmërisë së legjislacionit anglez: ai duhej të zbatohej ashtu siç shihej, në mënyrë tekstuale. Ajo që shihet si superiore, më e lartë se rendi pozitiv britanik i të drejtës së përgjithshme, vlente vetëm si një instrument për kufizimin e pushtetit të mbretit dhe për aq sa mbreti i kundërvihej vullnetit të sovranit (popullit). Shih për këtë, ligjet britanike duhej të merreshin ashtu siç janë, si vullnet suprem i sovranit, kurse e **drejta e përgjithshme** si një instrument që kufizonte pushtetin absolut të mbretit. Ky fakt në vetvete përbënte një paradoks, i cili edhe më fuqishëm u shpreh në kolonitë britanike përtej **Atlantikut**.

Përvoja në kolonitë britanike në **Amerikë** pati një kuptim tjetër, siç u konstatua më herët. Gjyqtarët kolonialë atje autorizoheshin që të shpërfillnin çdo legjislacion që binte ndesh me të drejtën pozitive angleze. Në kolonitë matanë, në këtë mënyrë, parimi i epërsisë së pakontrolluar të legjislacionit ndihmoi, nuk pengoi, formimin e një sistemi tërësisht të kundërt me atë në metropol. Ky sistem u jepte të drejtë gjyqtarëve që të kontrollonin vlefshmërinë e legjislacionit kolonial, kontroll që ushtrohej duke i pasur për pikë referimi ligjet e kurorës të nxjerra nga parlamenti anglez, si e drejtë pozitive, jo të **drejtën e përgjithshme**. Kjo përvojë ka qenë e njëjtë edhe në kolonitë tjera, si në Australi, Kanada, Indi etj., të cilat po ashtu pranuan kontrollin gjyqësor të vlefshmërisë së ligjeve pas pavarësimit të tyre. Kjo do të thotë se **SHBA-ja** nuk është i vetmi vend ish-kolonial që e ka ndjekur këtë rrugë.

Më pavarësimin e **SHBA**-së më 4 korrik 1776, ish-kolonitë britanike që përbënin shtetin e ri nxorën një nga një kushtetutat e tyre si akte themelore përmes së cilave bëhej zëvendësimi i **kartave**. Në kohën koloniale, **kartat** kishin shërbyer si kushtetuta të kolonive. Forma dhe përmbajtja e kushtetutave të reja të shteteve anëtare të SHBA-së ishte krejtësisht tjetër nga forma dhe përmbajtja e **kartave** të kohës koloniale. Vënia e tyre në jetë, megjithatë, la prapa vetes një trashëgimi të pasur në lëmin e gjyqësisë kushtetuese, praktikë që vazhdon deri në ditët e sotme. Njëjtë si në të kaluarën, kur ligjet e kolonive duhej të ishin në të njëjtën kohë në pajtim me **kartat** koloniale dhe me të drejtën angleze, ligjet e reja të ish-kolonive, të pavarësuar nga 4 korriku 1776, duhej të ishin në pajtim me kushtetutat e reja të shteteve të reja sovrane dhe të pavarura. Në rast mospajtimi të legjislacionit të ri me kushtetutat e reja të shteteve anëtare të **SHBA**-së, ai legjislacion konsiderohej si i pavlefshëm dhe nuk prodhonte asnjë pasojë juridike. Më vonë, pas vendimit në rastin **Marbury vs Madison**, legjislacioni i ri duhej të ishte në pajtim me Kushtetutën e SHBA-së (1789), si bazë e rendit të ri amerikan që ishte më superior dhe më i lartë se rendi i krijuar me kushtetutat e shteteve anëtare.

Në literaturë janë shënuar rastet e shumta të precedentëve gjyqësorë amerikanë që kanë mbrojtur këtë qëndrim, sipas të cilit kontrolli kushtetues i legjislacionit shtetëror bëhej duke pasur për bazë kushtetutat e reja të shteteve amerikane dhe ka nisur shumë kohë para rastit **Marbury vs. Madison**. Ky rast vetëm e ka ndërruar, përkatësisht zhvendosur pikën e referimit nga kushtetutat e shteteve anëtare në Kushtetutën e SHBA-së, si bazë e rendit të ri superior, më të lartë se rendi që ishte krijuar me kushtetutat e njësive federale. Ekziston një shekull praktikë gjyqësore amerikane që flet qartë për kryerjen e kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë së ligjeve, i cili bëhej gjatë kohës koloniale me qëllim të shikimit nëse ligjet e reja ishin të pajtim me **kartat** e kolonive amerikane.

Paragrafi 2 i nenit VI të Kushtetutës së SHBA-së nuk ka bërë asgjë tjetër vetëm se ka sanksionuar këtë praktikë të gjykatave amerikane nëpër shtetet e reja të pavarura, që ka ekzistuar para dhe pas fitimit të pavarësisë së tyre.[16] Këto gjykata siguronin, përmes interpretimit gjyqësor, supremacinë (epërsinë) e kushtetutave të reja kur ato u nxorën kundrejt çdo ligji apo akti tjetër juridik, ngjashëm siç kishin bërë më herët duke siguruar epërsinë e legjislacionit britanik kundrejt çdo legjislacioni tjetër të vlefshëm nëpër koloni, përfshirë kartat koloniale[17].

Paragrafi 2 i nenit VI, në veçanti siç është interpretuar nga **Xhon Marshall** (**John Marshall: 1755-1835**), paraqet një risi radikale dhe ka qenë, për dy arsye, i një rëndësie të madhe për sistemin kushtetues amerikan. Në rend të parë, ai paragraf ka shërbyer si burim i supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës kundrejt ligjeve dhe akteve tjera juridike. Së dyti, si i tillë, paragrafi ka mandatuar me pushtet të detyrueshëm gjyqësorin amerikan për të shpërfillur ligjet dhe aktet tjera juridike të cilat mund të binin ndesh

---

16 Neni VI (Paragrafi 2) i Kushtetutës së SHBA-së të vitit 1789: "Kjo Kushtetutë do të jetë ligji suprem në vend dhe ligjet e Shteteve të Bashkuara duhet të nxirren në bazë të saj, si dhe çdo traktat i bërë ose që mund të bëhen nën autoritetin e Shteteve të Bashkuara; gjyqtarët në secilin shtet do të jenë të detyruar ta zbatojnë pa marrë parasysh dispozitat e kundërta të cilat mund të ekzistojnë në kushtetutat apo ligjet e shteteve anëtare".

17 Edward Samuel Corwin, *The Doctrine of Judicial Review. Its Legal and Historical Basis, and Other Essays [1914]* (Princenton University Press: Princeton, 1914) fq. 1-78; Kermit L. Hall (ed.), *Major Problems in American Constitutional history. Documents and Essays. Vol. I: The Colonial Era Therough Reconstruction* (D.C. Heath and Company: Lexington, Massachusetts and Toronto, 1992) fq. 278-289.; William E. Nelson, *Marbury v. Madison. The Origins and Legacy of Judicial Review* (University Press of Kansas: Kansas, 2000) fq. 28-71.

me Kushtetutën. Siç u tha më herët, supremacia (epërsia) e Kushtetutës prezumohej, duke u bazuar në përvojën koloniale, sipas së cilës ligjet dhe çdo akt tjetër juridik nëpër koloni nuk guxonte të binte ndesh me vullnetin e sovranit (popullit), të shprehur përmes legjislacionit britanik si pasojë e epërsisë absolute të parlamentit kundrejt degëve të tjera të pushtetit. Në momentin e fitimit të pavarësisë më 1776, kolonitë dhe gjyqtarët e shteteve të reja amerikane vazhduan këtë praktikë të njëjtë, mirëpo tani nuk bëhej sigurimi i supremacisë (epërsisë) përmes interpretimit të legjislacionit britanik si një legjislacion superior, më i lartë se ai në koloni, por përmes interpretimit gjyqësor me qëllim sigurimin e supremacisë (epërsisë) së kushtetutave të reja të nxjerra nga 13 shtetet e pavarura amerikane. Kur u nxor Kushtetuta e vitit 1789, krejt në mënyrë të natyrshme u fut neni VI, paragrafi i dytë i të cilit garantonte epërsinë e saj kundrejt kushtetutave dhe legjislacionit të shteteve anëtare. Kjo Kushtetutë u pa si një ligj fundamental në nivel federal, më superiori dhe i pandryshueshëm në krahasim me ligjet dhe aktet tjera të zakonshme (qofshin federale apo ligje dhe aktet të tjera të shteteve anëtare).

Po të mos ndiqej kjo rrugë, Kushtetuta e vitit 1789 do të ishte vënë në një nivel të njëjtë me ligjet dhe aktet juridike të zakonshme (qofshin federale apo ligje dhe akte juridike të shteteve anëtare) me mundësi ndryshimi nga organi legjislativ në procedurë të zakonshme. Pranimi i kësaj alternative pati për pasojë faktin se çdo ligj ose akt tjetër juridik që binte ndesh me Kushtetutën, nuk konsiderohej i vlefshëm dhe, për pasojë, duhej të shpërfillej nga ana e gjyqësorit gjatë procedurës së zbatimit në një procedurë konkrete. Sikur të pranohej alternativa tjetër, gjë që nuk u bë, Kushtetuta do të ishte cilësuar si një nga ligjet e zakonshme dhe si një përpjekje e pavlerë për të kufizuar pushtetin, i cili, natyrshëm, nuk ka kufij. Në një rast të tillë, interpretimi gjyqësor me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës nuk do të kishte pasur asnjë kuptim.

Vendimi në rastin **Marbury v Madison** ka shpallur supremacinë (epërsinë) e Kushtetutës së vitit 1789 kundrejt kushtetutave shtetërore, ligjeve dhe akteve të tjera juridike të shteteve anëtare, si dhe e drejta e pushtetit gjyqësor për të shpërfillur (moszbatuar) ligjet dhe aktet tjera jo kushtetuese ka paraqitur një risi të madhe. Kjo, në parim, lidhet me natyrën e pandryshueshme të shumicës së kushtetutave nacionale të vendeve të botës. Mund të thuhet se, aktualisht, gati të gjitha kushtetutat kanë tendencën për të qenë të ngurta dhe jo lehtë të ndryshueshme. Lëvizja që filloi me **Marbury v Madison** kishte për qëllim pikërisht këtë. Që kushtetutat nacionale të interpretoheshin nga një organ gjyqësor apo ndonjë organ tjetër i mandatuar për interpretim të tekstit kushtetues me qëllim që të sigurohej supremacia (epërsia) e tyre kundrejt çdo ligji apo akti tjetër juridik. Me një fjalë, **Marbury v Madison** nisi epokën kolosale në konstitucionalizmin modern sipas të cilit gjykatat ose organet tjera të mandatuara për të ruajtur supremacinë (epërsinë) e kushtetutës nacionale nuk duhej të lejonin që ligjet dhe aktet e tjera të zakonshme të bien ndesh me Kushtetutën e vendit.

Shumica e vendeve të **Evropës** së sotme, në një fazë të caktuar zhvillimit të tyre kanë shprehur dëshirën dhe përpjekjet për të siguruar supremacinë (epërsinë) e kushtetutës së tyre kundrejt ligjeve dhe akteve tjera juridike. Përvojat evropiane, megjithatë, kanë qenë të ndryshme. Shtetet evropiane kanë përqafuar rrugë të ndryshme të arritjes së këtij qëllimi, të qëllimit të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së kushtetutës nacionale ndaj ligjeve dhe akteve të tjera juridike. Në disa raste janë përzgjedhur legjislaturat si organe të përshtatshme për të siguruar supremacinë (epërsinë) e kushtetutës (**kontrolli politik i kushtetutshmërisë**). Në raste të tjera kanë qenë organet gjyqësore të kompetencës së përgjithshme (gjyqësori i rregullt), si organe të mandatuara me këtë detyrë. Në fund, në shumicën e vendeve evropiane, kanë qenë organet krejtësisht të tjera, të ngjashme me gjyqësorin mirëpo me një kompetencë të veçantë për interpretim të kushtetutës me qëllim të vetëm sigurimin e supremacisë (epërsisë) së saj ndaj burimeve tjera të së drejtës. Në kategorinë e fundit të organeve hyjnë gjykatat kushtetuese si mekanizmat institucionalë më të përhapur për arritjen e këtij qëllimi, të ndara dhe të specializuara për detyrën e kontrollit kushtetues.

Aty ku legjislativi ka kompetencë dhe mandat për të siguruar supremacinë (epërsinë) e kushtetutës ndaj ligjeve të zakonshme dhe akteve të tjera juridike, brenda tij formohen trupa që bëjnë kontrollin kushtetues të ligjeve para se të votohen në parlament. I tillë është rasti me **Finlandën** dhe disa vende tjera evropiane, ku trupat e tillë në kuadër të legjislativit paraqiten si mjaft efektivë në arritjen e qëllimit primar - sigurimin e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës kundrejt ligjeve dhe akteve të tjera juridike. Këtu në vijim

flasim vetëm për organet gjyqësore dhe organe të tjera të ndara nga gjyqësori që posedojnë kompetencë të posaçme për interpretim të kushtetutës nacionale. Përvoja e kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë së ligjit dhe akteve të tjera juridike ka lindur me rastin **Marbury v Madison**, për t'u përhapur më vonë në tërë botën në një formë tjetër institucionale, por me qëllim të njëjtë – sigurimin e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës nacionale kundrejt çdo ligji apo akti tjetër juridik.

Ne e vazhdojmë diskutimin tonë me **Evropën** për shkak se këtu u çua deri në perfeksion praktika e sigurimit të supremacisë (epërsisë) së kushtetutës përmes kontrollit gjyqësor, praktikë që kishte nisur në **SHBA** qysh në kohët koloniale dhe që e diskutuam deri më tani.

2.4. Përhapja e kontrollit gjyqësor në Evropë dhe përtej

Ideja amerikane, sipas së cilës gjyqtarët kanë mandat për të mos zbatuar ligjet dhe aktet tjera juridike që i konsiderojnë si jo kushtetuese, fillimisht u përhap në **Meksikë**. Në këtë vend u krijua instituti **amparo contra leyes** ("amparo kundër ligjeve") që kishte për qëllim t'i jepte të drejtën gjyqësorit meksikan, njëjtë si në **SHBA**, për kryerjen e kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve me qëllim të sigurimit të epërsisë së **Kushtetutës së Meksikës** të vitit 1847. Më pastaj, ideja amerikane u përhap në vendet tjera të **Amerikës Latine**, ashtu që sot **amparo** mund të ushtrohet jo vetëm kundër ligjeve, por kundër çdo vendimi administrativ dhe gjyqësor, si dhe për të siguruar të drejtat e garantuara kushtetuese. Këtë institut me këtë natyrë tani e njohin edhe vendet tjera, si: Argjentina, Kili, Kolumbia, Haiti etj. Këto i diskutojmë në kapitullin e gjashtë që flet në mënyrë specifike për **Amerikën Latine**

Në Evropë, **Zvicra** ka qenë vendi i parë që ka krijuar institutin e ashtuquajtur **recurs de droit public**, i cili kishte për qëllim sigurimin e kushtetutshmërisë së ligjeve kantonale. Në fund të shekullit 19, **Norvegjia**, kurse në fillim të shekullit në vijim **Danimarka**, krahas **Rumanisë**, **Greqisë** dhe **Portugalisë**, ka mandatuar gjyqësorin e rregullt me të drejtën për kontroll kushtetues të ligjeve me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së kushtetutës nacionale. Të gjitha këto përpjekje u mbyllën pa ndonjë sukses të përhershëm. Vetëm pas **Luftës së Parë Botërore** mund të thuhet se në **Evropë** ka nisur një përpjekje konkrete më serioze, si në teori ashtu dhe në praktikë, me qëllim të sigurimit në mënyrë institucionale të epërsisë së kushtetutave nacionale kundrejt ligjeve dhe akteve të tjera juridike. **Austria** (1919-1938) dhe **Gjermania e Vajmarit** (1919-1933) kanë qenë djepi i kësaj praktike dhe i arsyetimit të saj teorik.

Në **Austrinë** e mundur në projektin e saj perandorak, **Hans Kelsen** (**Hans Kelsen: 1881-1973**) dhe një grup dijetarësh të kohës kanë shtjelluar deri në detaje kushtetutën austriake dhe gjermane, të cilat synonin të ndërtonin një shoqëri të re duke u bazuar, jo më në vullnetin e shumicës por në parametrat e demokracisë kushtetuese ashtu siç e njohim sot. **Kushtetuta e Austrisë** (1920) parashikonte themelimin e një gjykate kushtetuese, e cila kishte për detyrë kontrollin kushtetues të ligjeve dhe akteve të tjera me qëllim të sigurimit të epërsisë së Kushtetutës. Kontrolli kushtetues i ligjeve, në fillim ishte kontroll kushtetues paraprak (preventiv), pra para se të hynin në fuqi. Kushtetuta i jepte **Gjykatës Kushtetuese të Austrisë (GJKAu)** një rol qendror në definimin dhe vënien në jetë të demokracisë së re kushtetuese austriake. Në të njëjtën kohë me këtë, në fakt disa muaj më herët, u krijua **Gjykata Kushtetuese e** Çekosllovakisë (GJKÇK), pa ndonjë sukses: deri në fund të jetës së saj në prag të Luftës së Dytë Botërore, nuk bëri më shumë se kontrollin kushtetues të dy ligjeve.

Ardhja e **Hitlerit** në pushtet dhe nacifikimi i shumicës së vendeve të Evropës Qendrore pati për pasojë eliminimin e këtyre dy institucioneve, aq të rëndësishme për zhvillimin e demokracisë kushtetuese në truallin e Evropës. Gjykatat kushtetuese në këto dy vende paraqisnin antipodin e kundërt me diktaturat fashiste të instaluara në Evropën e kohës. E njëjta vlen edhe për **Kushtetutën e Republikës së Spanjës** të vitit 1931, e cila parashikonte ndërtimin e një gjykate kushtetuese, projekt që ngeli në letër si pasojë e përmbysjes së kësaj republike të tipit komunist nga ana e diktaturës së djathtë të instaluar më 1939 nga gjenerali **Francisko Franko** (**Francisco Franko: 1892-1975**)

Në **Gjermaninë e Vajmarit** nuk qe parashikuar themelimi i një gjykate të veçantë kushtetuese. Me një vendim të datës 4 nëntor 1925 të **Gjykatës së Lartë të Rajhut të Gjermanisë** (**GJLRGJ**), u ndoq praktika e kontrollit kushtetues të ligjit sipas modelit **Marbury vs Madison**. Vendimi, megjithatë, nuk

u bazua në dispozitat e **Kushtetutës së Vajmarit** (1919), sepse ato nuk parashikonin një të drejtë të tillë të gjyqësorit gjerman, por në parimin e ruajtjes së epërsisë së Kushtetutës sipas të cilit asnjë ligj apo akt tjetër juridik nuk guxon të jetë në kundërshtim me të. Ky vendim afirmonte fuqishëm precedentin e nisur në rastin **Marbury v Madison** dhe, së bashku me **Kushtetutën e Vajmarit**, ka shërbyer si shembull dhe pikë nisëse në debatin në mes të **Hans Kelsen** dhe **Karl Shmit** (**Carl Schmitt: 1888-1985**) në mesin e viteve njëzet të shekullit 20. Ky debat diskutohet gjerësisht në kapitullin në vijim. Këtu mjafton të thuhet përciptas se autori i parë, Hans Kelsen, me ngulm ka mbrojtur teorinë mbi gjykatën kushtetuese si gardian të epërsisë së kushtetutës, kurse i dyti, Karl Shmit, ka insistuar në institucionin e shefit të shtetit si gardian të epërsisë së kushtetutës.

Në përgjithësi, diskursi teorik, si dhe praktika në lëmin e gjyqësisë kushtetuese në mes të dy luftërave botërore, ka qenë mjaft e varfër dhe krejt në fillet e tyre. Vetëm pas mbarimit të **Luftës së Dytë botërore** nis një fazë e re dhe më serioze në zhvillimin e gjyqësisë kushtetuese siç e njohim sot. Kjo periudhë e zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese aktualisht ndahet në tri faza.[18] Këto faza në kapitullin tjetër diskutohen më gjerësisht, kurse këtu vetëm shkarazi, sa për informim bazik, diskutojmë lidhur me momentet kyçe në zhvillimin e gjyqësisë kushtetuese bashkëkohore.

E para fillon më themelimin dhe rithemelimin e gjykatave kushtetuese në **Austri**, **Itali** dhe **Gjermani** si dhe me pranimin e kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë si një mekanizëm kyç në sigurimin e epërsisë së kushtetutës në **Japoni**, **Indi**, **Kanada** dhe disa vende të tjera që modelohen sipas sistemit amerikan të kontrollit kushtetues.

Kushtetuta e Republikës së Italisë (1948), si çdo kushtetutë e nxjerrë pas përmbytjeve të thella shoqërore mëtonte të ishte programatike dhe progresive në të njëjtën kohë. Ajo sanksiononte vlera të reja dhe një sistem kushtetues tërësisht të ri që për qëllim parësor kishte ndryshimin rrënjësor të shoqërisë italiane, duke synuar që ta linte në harresë të kaluarën e hidhur që kishte ndodhur para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore nën regjimin e diktatorit **Benito Musloni** (**Benito Musolini: 1883-1945**). Në këtë ambient të ri, gjyqtarët e vjetër, në veçanti ata në **Gjykatën Supreme të Kasacionit** (**GJSKIt**) dhe në gjykatat italiane të apelit kishin shumë rezerva ndaj implementimit të kushtetutës së re, e cila bënte një ndërprerje radikale me të kaluarën, duke synuar shndërrimin e shoqërisë italiane në një shoqëri demokratike ku sundojnë kushtetuta e ligji, të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të minoriteteve.

Themelimi i **Gjykatës Kushtetuese** (**GJKIt**) në vitin 1956, shënon momentin kyç në zhvillimin e demokracisë kushtetuese italiane: tani e tutje, Kushtetuta e vitit 1948 kishte një garantues të pacenueshmërisë dhe vënies së saj në jetë. Kushtetuta deri atëherë qe cilësuar si një "kushtetutë e parealizueshme". Në **GJKIt**, vendi gjeti instrumentin parësor dhe jashtëzakonisht efektiv për të penguar rikthimin e regjimit autoritar të së kaluarës dhe, në të njëjtën kohë, për të siguruar paprekshmërinë e vlerave shoqërore dhe individuale të proklamuara në Kushtetutë. Përmes kontrollit kushtetues të ligjeve u hap mundësia që **GJKIt** të bëjë pastrimin e rendit italian nga mbeturinat legjislative të kohës së **Musolinit** dhe, në të njëjtën kohë, të vë në pah zbrazëtirat juridike që duheshin mbushur përmes aktivitetit të legjislativit të ri demokratik italian.

Kombi gjerman kishte vuajtur nga mbidemokracia, përkatësisht nga sundimi i pakontrolluar i parimit të shumicës. Që nga unifikimi gjerman më 1971 nën kancelarin gjenial **Oto fon Bizmark** (**Otto von Bismarck: 1815-1898**), Gjermania kishte probleme me kontrollin e vullnetit të shumicës, diçka që esencialisht ndihmoi ardhjen në pushtet më 1933 të diktatorit **Adolf Hitler** (**Adolf Hitler: 1889-1945**). Pas tragjedisë së **Luftës së Dytë Botërore**, njëjtë si Italia, **Gjermania** pa në kontrollin kushtetues mekanizmin kryesor që mund të garantonte demokracinë e re kushtetuese nga rrëshqitja e saj në diktaturë të

[18] Në fakt, si fazë e parë në zhvillimin e gjyqësisë kushtetuese në kuptimin global mund të konsiderohet periudha në mes të dy luftërave botërore. Kjo paraqet fazën e krijimit të gjykatave të para kushtetuese, si gjykata të kompetencës së veçantë dhe të ndara nga gjyqësori i rregullt. Në këtë periudhë ka nisur eksperimenti jo shumë i suksesshëm me gjyqësinë kushtetuese të tipit të centralizuar. Vendi i parë që bëri gjykatë të veçantë kushtetuese qe **Çekosllovakia** në shkurt të vitit 1920, pastaj Austria në tetor të atij viti, **Lihtenshtajni** (1925), **Greqia** (1927) Spanja (**1931**), **Kuba** (1940) dhe, së fundi, **Egjipti** (1941). Shih më shumë për këtë në L. Mezzetti, M. Belletti, E. D'Orlando, E. Ferioli, *LA GUISTIZIA COSTITUZIONALE* (CEDAM: Padova, 2007) fq. 104-105.

re të shumicës. Situatë e njëjtë mbretëronte në **Japoni**, ani se atje nuk u themelua një gjykatë kushtetuese e ndarë nga sistemi i korrputuar gjyqësor perandorak. Kjo rrethanë, përkatësisht mosthemelimi i gjykatës së re kushtetuese sipas modelit evropian nuk çonte shumë peshë sepse **Gjykata Supreme e Japonisë** (GJSJa) luajti një rol të madh në kontrollin kushtetues të ligjeve dhe akteve të tjera juridike, në mënyrë që mos të binin ndesh me Kushtetutën e Japonisë (1947). Kjo Kushtetutë u miratua nën përkujdesjen dhe kontrollin e plotë të regjimit ushtarak të gjeneralit amerikan **Daglas Mek Arthur** (**Douglas MacArthur: 1880-1964**). Si e tillë, ajo riorientonte Japoninë kah vlerat liberale të shoqërive demokratike kushtetuese perëndimore, një përvojë tërësisht e re krahasuar me sundimin absolut të perandorit **Hirohito** (**Michinomiya *Hirohito: 1901*-1989***),*** sundim që bazohej në **Kushtetutës Meiji** të vitit 1889.

Fenomeni i gjyqësisë kushtetuese, përkatësisht i kontrollit kushtetues të vullnetit të sovranit të shprehur përmes ligjeve nuk kufizohej vetëm në Itali, Japoni dhe Gjermani. Kushtetuta e **Austrisë** e vitit 1920, e rikthyer më 1946, së bashku me **GJKAu** dhe tërë sistemin kushtetues liberal që u pat shkatërruar nga regjimi diktatorial i kancelarit nacionalist austriak **Engelbert Dollfuss** pas të ashtuquajturës "shpërndarje" ("Selbstauflösung") të **Parlamentit të Austrisë**. (1933) Kjo kishte ndodhur si reagim kundër Partisë Social-Demokratike të Austrisë e cila kishte dërguar rastin e saj në **GJKAu.**[19]

Dy vendet tjera, të cilat ishin nën ndikimin e demokracive kushtetuese perëndimore, **Republika e Qipros** dhe **Republika e Turqisë**, po ashtu në fillim të viteve '60 të shekullit 20 me kushtetutat e reja krijuan gjykatat e veçanta kushtetuese. Këto gjykata u mandatuan për të kryer kontrollin kushtetues të ligjeve dhe akteve tjera juridike me qëllim të garantimi të supremacisë (epërsisë) së kushtetutave nacionale. Të dala nga jostabiliteti i gjatë, në kontrollin kushtetues **Qipro** dhe **Turqia** gjetën një instrument të fuqishëm për sigurim të stabilitetit në vend dhe për zhvillimin paqësor të demokracive të reja kushteuese.

Si zhvillim më i çuditshëm dhe i rëndësishëm i fazës të zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese ka qenë ish-**Jugosllavia**. Në këtë vend më 1963 u themelua gjykata federale kushtetuese, si dhe gjykatat kushtetuese të gjashtë ish-republikave jugosllave. Kosova dhe Vojvodina themeluan gjykatat e tyre kushtetuese vetëm në fillim të viteve '70 të shekullit të kaluar, pas nxjerrjes së amendamenteve kushtetuese të vitit 1971. Kontrolli i kushtetutshmërisë ishte kontroll i tipit të demokracive komuniste ku pushteti ishte një dhe i pandarë, ushtrohej përmes kuvendit si organi më i lartë i diktaturës së proletariatit në të cilën partia komuniste shërbente si avangardë. Kjo në vetvete përbën një paradoks nëse matet me kriteret e konstitucionalizmit modern perëndimor ku sigurimi i ndarjes së pushtetit, i sundimit të ligjit dhe respektit për të liritë dhe të drejtat themelore përbëjnë vlerat kyçe të cilat i siguron dhe mbron gjykata kushtetuese. Në rastin e ish-**Jugosllavisë**, esenca e gjyqësisë kushtetuese qëndronte në atë se kontrolli kushtetues i ligjeve kishte për qëllim që të garantonte epërsinë e kushtetutës federale dhe republikane/krahinore, kushtetuta që garantonin epërsinë e kuvendit si organi më i lartë i pushtetit dhe sundimin e diktaturës së proletariatit, jo të kushtetutës e ligjit dhe respektimin e të drejtave e lirive themelore të individit. Në këtë sistem, pushteti ishte një dhe i pandarë, me kuvendin (federal dhe republikan/krahinor) si organin më të lartë të pushtetit, i cili pushtet supozohej se ushtrohej, në emër të proletariatit, nga ana e partisë komuniste si avangardë e tij, jo në emër të kushtetutës (federale dhe republikane/krahinore) dhe ligjit.

Në vendet tjera ish-komuniste, **Rumani**, **Poloni** dhe Çekosllovaki, ka pasur përpjekje, por pa sukses, për futjen e sistemit jugosllav të kontrollit kushtetues. Këto përpjekje, si dhe praktika në ish-**Jugosllavi**, treguan se kontrolli kushtetues si instrument jo domosdo ka për synim promovimin dhe zhvillimin e demokracisë kushtetuese të tipit perëndimor. Më tepër mund të thuhet se kontrolli kushtetues i ligjeve dhe i akteve të tjera juridike paraqet një instrument të dobishëm për krijimin dhe promovimin e stabilitetit kushtetues si dhe për vënien në jetë të kushtetutës si marrëveshje dhe vullnet sublim i një gjenerate, pa marrë parasysh përmbajtjen e vullnetit të kësaj marrëveshjeje. Në një moment, ky vullnet mund të ketë pasur si qëllim përligjësimin e sundimit monarkik kushtetues, herën tjetër përligjësimin e sundimit monarkik absolut, qeverisjen kushtetuese

[19] Cf. more on this, a seminal work by Charles A. Gulick, *Austria from Habsburg to Hitler. Vol. II. Fascism's Subversion of Democracy* (University of California Press, Berkeley and Los Angeles, 1948) 1410-1423 (autori diskuton ngjarjet para dhe pas mbylljes së **GJKAu** dhe diktaturën e regjimit **Dollfus**; ky regjim kishte sunduar përmes dekreteve qeveritare bazuar në autorizimet nga gjendja e jashtëzakonshme që ishte future më 4 mars 1934; ky autor po ashtu jep edhe pikëpamjet e asaj kohe të dijetarit **Hans Kelsen** që kishte kritikuar ashpër veprimet jokushteuese të regjimit **Dollfus**, në veçanti ato që kishin të bënin me anulimin e mandateve të socialdemokratëve austriakë).

demokratike të proveniencës liberale apo, së fundi, sundimin jodemokratik të vetëm një personi apo kaste teokratike (vendet muslimane). Këto aspekte i diskutojmë më gjerësisht në kapitullin 5 dhe 7 që flasin për gjyqësinë kushtetuese në vendet ish-komuniste dhe vendet islamike respektivisht.

Deri në fillimin e fazës së dytë të zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese, e cila nis me themelimin e gjykatave kushtetuese në **Spanjë** (1979) dhe **Portugali** (1983) dhe me rikthimin e demokracisë në **Greqi.** Në këtë vend, Gjykata Supreme sipas modelit amerikan mori rolin e kontrolluesit të vullnetit të shumicës dhe sigurimin supremacisë (epërsisë) së kushtetutës së re greke të vitit 1975. Në **Evropë** dhe më gjerë, gjyqësia kushtetuese, e kuptuar si kontrolluesi i kushtetutshmërisë së ligjeve, nisi të marrë hov gjithandej. Në këtë përhapje të shpejtë të kontrollit kushtetues të ligjeve dhe akteve tjera juridike duhet të përmenden edhe ish-kolonitë britanike, si Kanada e Australia, India dhe Pakistani. Ne vendet e Amerikës Latine, si Urugvaj, Brazili dhe Meksiko, po ashtu kontrolli kushtetues i ligjeve nga ana e gjyqësorit të rregullt u bë pjesë e sistemit kushtetues të këtyre vendeve. Përveç gjyqësorit të rregullt, disa vende në **Amerikën Latine** në këtë kohë formuan gjykatat kushtetuese sipas modelit evropian, diçka që diskutohet gjerësisht në kapitullin e gjashtë në vijim. Vendet e Amerikës Latine dhe gjyqësia kushtetuese atje diskutohen gjerësisht dhe më në detaje në kapitullin e gjashtë të librit.

Faza e fundit në zhvillimin e gjyqësisë kushtetuese nis me rënien e komunizmit më 1989. Me mbarimin e **Luftës së Ftohtë**, shumica e vendeve ish-komuniste në Evropë dhe në Azinë Qendrore themeluan gjykatat kushtetuese si institucione të ndara nga gjyqësori i rregullt dhe me një rol jashtëzakonisht të madh në kontrollin e pushteteve të reja në mënyrë që të mos degjenerojnë në diktatura postkomuniste. Në shumicën e këtyre vendeve, gjykatat kushtetuese e kanë luajtur këtë rol më shumë sukses. Në disa prej tyre, gjykatat kushtetuese nuk kanë pasur aq shumë sukses, siç ka qenë rasti me **Bjellorusinë** dhe **Federatën Ruse**. Presidenti rus **Boris Jelcin** (**Boris Yeltsin:1931-2007**) e pat mbyllur Gjykatën Kushtetuese për një kohë (1993-1995) sepse nuk i pëlqenin vendimet e saj me të cilat bëhej kontrolli i pushtetit të tij absolut.

Në ato vende ku u fut ankesa kushtetuese si instrument për mbrojtjen dhe promovimin e lirive dhe të drejtave kushtetuese, gjykatat kushtetuese luajtën një rol mjaft të madh në kontrollin e pushtetit të gjykatave të rregullta, duke mos e lejuar arbitraritetin e këtij pushteti, siç kishte ndodhur në të kaluarën komuniste. Në disa vende, siç ishte rasti më **Hungarinë**, ishte futur **actio popularis**, përmes së cilës mundësohej ushtrimi i kontrollit të pushtetit legjislativ edhe nga ana e vetë qytetarëve të zakonshëm[20]. Me këtë mjet, në çdo kohë mund të iniciohej kontrolli kushtetues i çdo ligji për të cilin vlerësohej se mund të cenonte të drejtat dhe liritë kushtetuese. Në këtë fazë, të rralla kanë qenë vendet ish-komuniste që nuk kanë themeluar gjykatë të veçantë kushtetuese me juridiksion të posaçëm, siç është rasti me **Estoninë**, e cila rolin e kontrollit kushtetues të ligjeve dhe akteve tjera juridike ia besoi Gjykatës Supreme të këtij vendi.[21] Edhe për këtë do të flitet më shumë në kapitullin në vijim.

2.5. Komente dhe pyetje

2.5.1 Para **Revolucionit Francez**, sistemi gjyqësor ishte një dorë e zgjatur e mbretit ku gjyqtarët mund t'i shisnin dhe blinin pozitat e tyre gjyqësore, siç blihet çdo send apo e drejtë mbi sendin. Si quhej ky sistem ku gjyqtarët francezë u konsideruan të kompromet uar dhe çfarë pasoja ka pasur ky kompromet im i tyre në lëmin e kontrollit kushtetues të ligjeve të nxjerra pas Revolucionit?

2.5.2. Pas **Revolucionit Francez** janë krijuar dy organe kushtetuese me autorizime të veçanta dhe të ndryshme: **KSHFr** dhe **KKFr**. Cili ka qenë dhe është funksioni parësor i njërit dhe tjetrit organ dhe si ka ardhur deri te formimi i tyre? Si kanë evoluar këto dy organe shtetërore ashtu që sot ato mund të bëjnë edhe kontrollin kushtetues të akteve juridike, jo vetëm kontrollin kushtetues të veprimit administrativ të shtetit (**KSHFr**), përfshirë këtu edhe kontrollin kushtetues të ligjeve pas hyrjes së tyre ne fuqi (**KKFr**)?

---

[20] Më shumë për rastin e Hungarisë, që nga themelimi i Gjykatës Kushtetuese, shih në Laszlo Solyom and Georg Brunner, *Constitutional Judiciary in a New Demoracy. The Hungarian Constitutional Court* (The University of Michigan Press: Michigan, 200); Radoslav Prochazka, *Mission Accomplished. On Founding Constitutional Adjudication in Central Europe* (CEU Press: Budapest / New York, 2002) fq. 49-59; 113-139; 222-234.

[21] Vello Pettai, "Estonia's constitutional Review mechanisms: a guarantor of democratic consolidation". Në Vello Pettai and Jan Zielonka (eds.) *The Road to the European Union Vol. 2: Estonia, Latvia and Lithuania* (Manchester University Press: Manchester/New York, 2003) fq. 75-103.

2.5.3. Në sistemin francez ekziston shprehja **blloku i kushtetutshmërisë** (**bloc de constitutionalite**). Çka përfshihet me këtë term aktualisht dhe si ka ndikuar ky term në krijimin e mundësive që **KKF-ja** të fitojë të drejtën e ushtrimit të kontrollit represiv të ligjeve dhe akteve të tjera juridike më të ulëta se ligji?

2.5.4. Kontrolli kushtetues në **SHBA** ka një histori të çuditshme, por që kjo ka një shpjegim: në kohët koloniale në kolonitë amerikane gjyqtarët kujdeseshin që të siguronin epërsinë e legjislacionit të kurorës kundrejt çdo **karte koloniale** apo norme tjetër që zbatohej nëpër kolonitë britanike. Kjo nënkuptonte se aktet më të larta në secilën koloni, të njohura si **karta,** duhej të ishin në pajtim me legjislacionin britanik, i cili miratohej nga Parlamenti. **Kartat** konsideroheshin si lloj kushtetutash të kolonive, kurse Parlamenti britanik konsiderohej si organ suprem dhe vetë goja e sovranit (popullit). Kur u pavarësuan kolonitë amerikane më 4 korrik 1776, praktika e sigurimit të epërsisë së Parlamentit britanik përmes interpretimit gjyqësor nëpër kolonitë amerikane prodhoi një rezultat krejtësisht tjetër: në ndërkohë që në **Britani** nuk lejohej sfidimi i epërsisë të së **drejtës së përgjithshme**, në kolonitë amerikane çdo **kartë** duhej të ishte në pajtim me legjislacionin britanik dhe këtë epërsi të legjislacionit britanik e siguronin gjyqtarët kolonial. Ky rezultat u reflektua në Kushtetutën e SHBA-së dhe në rastin e njohur si **Marbury vs Madison**. Tregoni si ka ndodhur ky proces?

2.5.5. Përhapja e gjyqësisë kushtetuese ka qenë e ngadaltë në kohën pas triumfit të praktikës amerikane të kontrollit kushtetues të ligjit me qëllim të sigurimit të epërsisë së kushtetutës nacionale, përhapje që ka nisur në vitin 1803 me rastin **Marbury vs Madison**. **Meksika** qe vendi tjetër që e instaloi institutin **amparo contra leyes**. Kur dhe ku u formua gjykata e para kushtetuese? Kur dhe në mes të kujt filloi debati i parë teorik lidhur me natyrën e gjykatave kushtetuese moderne dhe cila ishte esenca e debatit?

2.5.6. Ka disa faza në zhvillimin e gjyqësisë kushtetuese, duke nënkuptuar me këtë zgjidhjet nacionale për themelim të gjykatave të reja kushtetuese me kompetenca të veçanta dhe të ndara nga gjykatat e rregullta me kompetencë të përgjithshme ose zgjidhjet që ua lënë gjykatave të rregullta ushtrimin e këtij autorizimi për kontroll të kushtetutshmërisë. Cilat janë këto faza dhe cilat janë vendet me të cilat secila nga këto faza identifikohen?

2.5.7. Në fazën e parë, tri janë vendet të cilat i kanë dhënë vulën zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese, duke pasur gjykata kushtetuese të ndara nga gjyqësori i rregullt. Cilat janë këto vende? Cili është dallimi në mes të **Austrisë** dhe dy vendeve tjera?

2.5.8. Gjyqësia kushtetuese nuk është monopol vetëm i vendeve demokratike perëndimore. Kështu, ta zëmë, ish-**Jugosllavia** komuniste ka kultivuar gjyqësinë kushtetuese që nga viti 1963. Cilat ishin cilësitë e gjyqësisë kushtetuese të këtij vendi krahasuar me vendet e demokracive kushtetuese perëndimore?

2.6. Lexim shtesë

- Jean–Pierre Massias, *Droit constitutionel des Etats d'Europe de l'Est* (Presses Universitaire de France: Paris, 1999)
- Kristaq Traja, *Drejtësia Kushtetuese* (Luarasi: Tiranë, 2000)
- Jan Zielonka, *Democractic Consolidation in Eastern Europe. Vol. 1. Institutional Engeneering* (Oxford University Press: Oxford, 2001)
- Jan Zielonka and Alex Pravda, *Democractic Consolidation in Eastern Europe. Vol. 2. International and Transnational Factors* (Oxford University Press: Oxford, 2001)
- John Bell, *French Constitutional Law* (Clarendon Press: Oxford, 2001)
- Levent Gonenc, *Prospects for Constitutionalism in Post-Communist Europe* (Martinus Nijhoff Publishers: The Hague, 2002)
- Knut Midgaard & Bjorn Erik Rasch, *Demokracia: kushtet dhe pasojat* (Rozafa: Prishtinë, 2004)
- Visar Morina, *Gjyqësia Kushtetuese* (Instituti Për Studime Kushtetuese dhe Parlamentare: Prishtinë, 2013)

3. KONTEKSTI DHE ARSYETIMI TEORIK I LINDJES DHE ZHVILLIMIT TË GJYQËSISË KUSHTETUESE

Përgjithësisht. - Në kapitullin paraprak diskutuam për origjinën teorike-filozofike dhe institutet e para që ngjasojnë me gjyqësinë kushtetuese, të cilat kanë ekzistuar në antikë, **Mesjetë** dhe më pastaj përgjatë shekujve formativë të shtetit modern. Aty pamë se si ekzistimi i një rendi superior, më i lartë se rende tjera shoqërore, përbën parakushtin e domosdoshëm, por jo të mjaftueshëm, për lindjen e gjyqësisë kushtetuese. Ky rend superior, më i lartë se të tjerët, ka ekzistuar në të kaluarën, siç kanë ekzistuar institute të ngjashme me gjyqësinë kushtetuese që kanë shërbyer si mekanizëm për të siguruar superioritetin, lartësinë, e rendit të tillë superior, më të lartë se rendet tjera në një shoqëri të organizuar në shtet. Për këtë janë dhënë edhe arsyetimet teorike të filozofëve të ndryshëm dhe këtë po ashtu e sqaruam në kapitullin pararendës. Ajo që ka çuar në lindjen e gjyqësisë kushtetuese ashtu siç e njohim sot ka qenë ekzistimi i kushtetutave të shkruara, të cilat kanë fituar një fuqi të caktuar normative dhe që është dashur ta kenë një mekanizëm të qartë gjyqësor për ta vënë në jetë këtë normativitet të kushtetutave të reja. Kjo në fillim ka lindur si gjyqësi kushtetuese embrionale brendapërbrenda sistemit ekzistues gjyqësor, për t'u ndarë me kalimin e kohës edhe institucionalisht si një trup kushtetues i veçantë prej gjyqësorit të rregullt dhe, për pasojë, për të mos qenë pjesë e pushteteve të ndara dhe të balancuara, por vetë gardiani dhe ruajtësi i këtij pushteti të ndarë dhe të balancuar.

Ky kapitull ka më shumë karakter praktik dhe mëton të tregojë përvojën me gjyqësinë kushtetuese dhe arsyetimet konkrete teorike e filozofike që kanë mbështetur një praktikë të tillë. Kjo për faktin se gjyqësia kushtetuese, si çdo profesion dhe veprimtari tjetër shtetërore, ka lindur dhe është zhvilluar në një kontekst të dhënë shoqëror dhe jo jashtë tij. Në këtë kuptim, mbase titulli i këtij kapitulli do të ishte më i qëlluar sikur të kishte qenë "sociologjia e gjyqësisë kushtetuese". Një titull i tillë, megjithatë, do ta kishte larguar vëmendjen e lexuesit nga thelbi i titullit të këtij libri universitar dhe do ta kishte shndërruar narrativin e librit në një tregim të thatë e pa përmbajtje lidhur me filozofinë e së drejtës në periudhat që trajtohen në seksionet në vijim. Kjo ka qenë arsyeja pse nuk kemi përzgjedhur qasjen e tillë sociologjike, duke u fokusuar në "rrjepjen" (lexo: zhveshjen) e gjyqësisë kushtetuese si institut dhe fenomen juridik nga ngarkesat e tepërta shoqërore, për t'ia lënë në fund veç skeletit të saj edhe "mish" (lexo: përmbajtje), aq sa i duhet një juristi mesatar për të kuptuar tematikën si tërësi.

Seksioni i parë jep një pasqyrë përmbledhëse të lindjes dhe zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese në Evropë, Amerikën Latine dhe gjetiu, si dhe ndikimin që ka pasur Evropa dhe SHBA në përhapjen e llojeve të caktuara të gjyqësisë kushtetuese. Çdo gjë nis me fundin e shekullit XVIII. Në këtë seksion diskutojmë edhe arsyetimet teorike të dhëna nga etërit themelues të konstitutcionalizmit amerikan, si **Xhon Adams** (John Adams: 1735-1826), **Aleksander Hamilton** (Alexander Hamilton: 1757-1804) dhe **Xhejms Madison** (James Madison: 1751-1836), pastaj ato të dijetarëve evropianë, kolosëve të dijes së drejtësisë **Hans Kelsen** (Hans Kelsen: 1881- 1973) dhe **Karl Shmit** (Carl Schmitt: 1888-1985) por edhe arsyetimet e mëhershme teorike të **Benjamin Konstant** (Benjamin Constant: 1767-1830) dhe autorëve të tjerë që kanë qenë të involvuar në trajtimet e çështjes së demokracisë kushtetuese moderne.

Debatit **Kelsen – Shmit** i kthehemi më gjerësisht në seksionin e dytë të këtij kapitulli. Pa kuptimin e përmbajtjes së këtij debati, jashtëzakonisht të thellë dhe shumëdimensional, nuk mund të kuptohet gjyqësia bashkëkohore kushtetuese. Ai debat sot e kësaj dite ngjall debate të shumta, shkrime e polemika, të cilat sillen e pështillen rreth një problemi kyç: kush duhet të jetë gardian i kushtetutës? A duhet të jetë ai shefi i shtetit apo ndonjë institucion tjetër brenda sistemit kushtetues, apo një organ krejtësisht i ndarë

nga sistemi i qeverisjes, që ka juridiksion të qartë kushtetues për mbrojtjen e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës. Këtu futen edhe shtjellimet tona për qëndrimet e **B. Konstant**, për shkak se ato kanë ndikuar në formimin e **K. Shmit** lidhur me shefin e shtetit si gardian i kushtetutës.

Seksioni tretë sërish merr në diskutim zhvillimet e gjyqësisë kushtetuese, ashtu siç janë manifestuar ato në tri fazat apo periodizimet e këtij zhvillimi. Ky periodizim është standard i pranuar gjerësisht, të cilit iu kemi përmbajtur edhe ne. Në kuadër të këtij shtjellimi të zhvillimeve praktike në gjyqësinë kushtetuese, sërish i kthehemi vendeve konkrete për të parë si duken ato në disa prej vendeve më kryesore. Pikë nisëse këtë herë është **Lufta e Dytë Botërore** dhe zhvillimet në gjyqësinë kushtetuese pas mbarimit të saj. Aty-këtu kemi prekur edhe gjyqësinë kushtetuese të disa vendeve arabe dhe myslimane para vitit 1945, me qëllim të ruajtjes së kontinuitetit në mënyrë që, kur të diskutohet sërish më në detaje gjyqësia kushtetuese e këtyre vendeve, lexuesi të këtë një pasqyrë koherente për lindjen dhe zhvillimin e gjyqësisë kushtetuese në këto vende.

Seksioni i katër diskuton rastet e përhapjes marramendëse të gjyqësisë kushtetuese pas rënies së komunizmit dhe përqafimit kryesisht të modelit kelsenian të gjyqësisë kushtetuese nga ana e vendeve ish-komuniste. Veç në vendet ish-komuniste, përhapja e gjyqësisë kushtetuese ka ndodhur edhe në vendet tjera të botës, të cilat në këtë seksion paraqiten në mënyrë telegrafike. Kjo sepse në kapitujt tjerë në vijim flitet për gjyqësinë kushtetuese në vendet e ndryshme të botës në mënyrë mjaft të detajuar.

Seksioni i pestë dhe i gjashtë respektivisht ngërthejnë komente e pyetje dhe literaturën shtesë që lidhet me tematikën e shtjelluar në këtë kapitull, ashtu që lexuesit mund të testojnë njohuritë e tyre dhe të ngritin kërshërinë e mëtejshme për t'u marrë me gjyqësi kushtetuese.

3.1. Shekujt formativë të gjyqësisë kushtetuese: fundi shekullit XVIII deri te mbarimi i Luftës e Dytë Botërore (Evropa, Amerika Latine dhe vendet arabe)

Kontrolli kushtetues, në të gjitha format që manifestohet aktualisht, ka zanafillën e vet në fenomenin e konsolidimit të kuptimit modern të kushtetutës si një tekst normativ, autonom dhe objektiv, që rregullon jetën socio-politike, ekonomike dhe kulturore përmes normave bazë të dakorduara nga të gjitha forcat shoqërore të një kohe e hapësire të caktuar. Autonomia dhe objektiviteti i kushtetutës ekziston dhe shprehet në mënyrë të pavarur nga raporti ditor i forcave në mes të subjekteve dhe organeve kushtetuese.[1] Në të njëjtën kohë, kushtetuta i reflekton dhe formëson këto subjekte dhe organe kushtetuese dhe proceset që zhvillohen në to dhe rreth tyre. Kjo zanafillë, e kuptuar në këtë mënyrë, bëri që kushtetuta të nis e kuptohet në mënyrë graduale si një normë me karakter të normës pozitive me karakter normativ që kërkon vënien e saj në jetë përmes mekanizmave të caktuar, siç është rasti me ligjin. Këtë cilësi normative kushtetuta e fiton shumë më vonë në procesin e evoluimit të vet.

Kjo zanafillë lidhet me fundin e shekullit XVIII dhe me revolucionet në **Amerikë** dhe në **Francë**. Koncepti modern i kushtetutës në veçanti është afirmuar gjerësisht falë shtjellimeve teorike të tre baballarëve të kombit amerikan: **Xh. Adamas**, **A. Hamilton** dhe **Xh. Madison**. Shtjellimet e tyre kishin për objekt kryesor aspektet teorike të ngjarjeve revolucionare që ndodhën në kolonitë e **Amerikës së Veriut** (1765-1783) dhe në **Francë** (1789-1799). Këto dy revolucione përmbysën konceptet e vjetra mbi natyrën e pushtetit dhe origjinën e tij.

Idetë me të cilat u brumosën revolucionet në fjalë kanë qenë të bazuara në botëkuptimet bazike të **Iluminizmit** të shekujve XVII dhe XVIII, përkatësisht me idetë e besimit në arsyen njerëzore dhe origjinën krejt njerëzore të pushtetit politik dhe tjetër. Kjo nënkuptonte, sipas shtjellimeve teorike të tre baballarëve themelues të kombit amerikan, se pushteti me origjinë njerëzore mund të formohej, të ushtrohej, të kufizohej dhe, së fundi, të fitohej vetëm përmes rregullave të paracaktuara më parë, të vëna në një tekst të quajtur kushtetutë. Tani e tutje, thënë ndryshe, qartë u përcaktua se pushteti kishte burim njerëzor,

[1] Gustavo Zagrebelsky, *La legge e la sua giustizia* (Il Mulino: Bologna, 2008) fq. 322-325.

krejt racional, pra jo burim hyjnor ashtu siç qe menduar përgjatë shekujve. Kjo ndryshoi rrënjësisht marrëdhënien e njeriut me pushtetin si dhe marrëdhënien e pushtetit me vetveten dhe shoqërinë si tërësi.

Si pasojë e këtij ndryshimi u krijuan burimet e reja të së drejtës me një natyrë thellësisht të ndryshme nga e kaluara: në maje qëndronte një e drejtë superiore, më e lartë, që cilësohej si e drejtë natyrore, por që kishte arsyetim racional, kurse poshtë saj një e drejtë tjetër, më e ulët, që cilësohej si rrjedhojë e të drejtës natyrore dhe që po ashtu kishte arsyetim racional. Ky arsyetim racional thoshte se pushteti buronte nga e drejta natyrore, jo nga e drejta hyjnore. Kjo e drejtë natyrore në krye të saj e ka një kushtetutë, të cilës i nënshtrohet çdo akt tjetër juridik më i ulët. Kjo fazë e këtij ndryshimi radikal koincidon me shekujt XVIII dhe XIX dhe me revolucionet në **Amerikë** dhe **Francë**, si dhe më përhapjen e ideve të tyre nëpër vendet e ndryshme të **Evropës** dhe botës. Kjo supremaci (epërsi) e kushtetutës dhe e rendit juridik që bazohej në te në mënyrë të pashmangshme kërkonte një mekanizëm për ta siguruar supremeacinë (epërsinë) e saj çdoherë kur ajo cenohej nga subjektet e së drejtës. Nuk mjaftonin vetëm idetë fisnike mbi ndarjen e pushtetit si mekanizëm për mbrojtjen e tekstit kushtetues dhe frymës së tij. Fillimisht, megjithatë, kjo supremaci (epërsi) e kushtetutës u sigurua dhe u bë realitet si rrjedhojë e aktivitetit të njërit prej tri pushteteve – gjyqësorit. E thënë me fjalë të tjera, idetë e para në këtë drejtim kërkonin që njëri prej tri pushteteve të ishte sipër tjerëve për të siguruar supremacinë (epërsinë) e vullnetit të sovranit (popullit) të shprehur në tekstin kushtetues. Ai pushtet ishte gjyqësori. Shumë vonë, pas gati një shekull e gjysmë, në **Evropë** lindi ideja e krijimit të një organi tjetër, të ndarë nga gjyqësori, që do të kishte autorizim për të ruajtur dhe mbrojtur supremacinë (epërsinë) e vullnetit të sovranit (popullit) të shprehur në tekstin kushtetues.

Në periudhën nga fundi i shekullit XVIII deri në mbarim të **Luftës së Dytë Botërore** është kristalizuar instituti që sot quhet gjyqësi kushtetuese në të gjitha format e manifestimit të saj. Përjashtim bën gjyqësia kushtetuese në lëmin e mbrojtjes së të lirive dhe drejtave njerëzore: gjykatat kushtetuese fituan të drejtën e kontrollit kushtetues të veprimeve dhe mosveprimeve të autoriteteve publike me qëllim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive kushtetuese vetëm në mesin e shekullit XX, për t'u bërë juridiksion mjaft i përhapur i gjyqësisë kushtetuese pas rrënimit të komunizmit më 1989. **H. Kelsen**, ideatori i gjyqësisë kushtetuese që ushtrohet nga një organ me juridiksion të veçantë kushtetues dhe që nuk bën pjesë në sistemin e gjyqësorit të rregullt, nuk e ka pasur as idenë më të vogël se një ditë gjykata kushtetuese, ideator i së cilës kishte qenë, mund të shndërrohet një ditë nga një "ligjvënës negativ", siç e kishte thënë vet ai, në mbrojtës kryesor të lirive dhe të drejtave kushtetuese. Ky segment, siç do të shihet në seksionin në vijim, nuk ka qenë fare prezent në shtjellimet e tij teorike: në debatin në mes tij dhe kundërshtarit kryesor të gjyqësisë kushtetuese, ai nuk ka bërë fjalë për mundësinë që një ditë këto të drejta dhe liri kushtetuese të mund të jenë objekt mbrojtjeje kushtetuese nga ana e gjykatave kushtetuese, fenomen që sot fare nuk kontestohet nga askush. Në fakt, ka qenë **K. Shmit** ai që është shërbyer me kapitullin e dytë të **Kushtetutës së Vajmarit** (**KV**) të vitit 1919, si argument për të mohuar gjyqësinë kushtetuese, duke e cilësuar atë si "kushtetutën e dytë të Gjermanisë". E thënë me fjalë të tjera, ky dijetar kapitullin e dytë të **KV**, e cila ka shërbyer si bazë në shtjellimet e tij teorike që mohojnë gjyqësinë kushtetuese, e ka cilësuar si kushtetutë të dytë gjermane. Kjo sepse, sipas tij, kapitulli sanksiononte një sistem kushtetues të lirive dhe të drejtave të njeriut, të cilat detyrojnë shtetin për një sjellje të caktuar kundrejt tyre, si dhe për krijimin e një mekanizmi të përshtatshëm për vënien e tyre në jetë.

Këto rezerva ndaj fuqisë normative të dispozitave kushtetuese mbi liritë dhe drejtat e njeriut dhe ndaj gjyqësisë kushtetuese si mekanizëm implementues të tyre nuk ekzistojnë në kohët tona. Vënia në jetë e kartave për liritë dhe të drejtat e njeriut, që sot ekzistojnë në të gjitha kushtetutat nacionale, përmes mekanizmit gjyqësor aktualisht merret si diçka krejt e mirëqenë dhe si diçka që ka të bëjë me vetë natyrën e punës së gjykatave kushtetuese. Për më tepër, gjykatat kushtetuese, jo rrallë konsiderohen si gjykata të lirive dhe të drejtave kushtetuese sepse shihen si garantuesit kryesorë të vënies së tyre në jetë.

Implementimi i ideve revolucionare, të brumosura me ide iluministe lidhur me origjinën dhe natyrën e pushtetit politik, nuk ka ndodhur menjëherë. Në truallin evropian, **Franca** pati një mosbesim të madh

ndaj gjyqësorit si gardian i kushtetues dhe i vullnetit të popullit, i cili nga francezët shihej në **frymën rusoane**, si diçka që nuk mund të interpretohej nga gjyqtarët. Në ish kolonitë amerikane, më 1803 u pranua se gjyqësori mund të ishte interpretues i vullnetit suprem të popullit. Kjo ndodhi si pasojë e një zhvillimi specifik përtej Atlantikut, diçka që do të diskutohet në vijim.

Evropa si tërësi dhe **Amerika Latine** u ndikuan nga dy këto revolucione në SHBA dhe Francë, gjë që u reflektua në praktikë përgjatë periudhës së shek. XIX deri në mesin e shekullit XX, kur Evropa përfundimisht krijoi një identitet të veçantë të gjyqësisë kushtetuese, falë ideve dhe shtjellimeve të thella teorike të **H. Kelsen** dhe përvojës së nisur në mes dy luftërave botërore në Çekosllovaki dhe Austri.

Të shohim si duket kjo sipas vendeve evropiane.

Greqia ka qenë vendi i parë që ka vënë në jetë kontrollin kushtetues sipas modelit amerikan gjatë shekullit XIX. Më 1847, **Gjykata Supreme e Greqisë** (**GJSG**) u autorizua me Kushtetutë që të bënte kontrollin kushtetues të legjislacionit. Në fillim kishte të drejtën e kontrollit të legjtimitetit kushtetues të legjislacionit vetëm në aspektin formal, kurse më 1871 dhe 1897 kjo gjykatë u autorizua edhe për kontrollin e legjitimitetit kushtetues të legjislacionit në aspektin material, pra në aspektin e përmbajtjes së ligjeve, për të parë nëse ato cenonin supremacinë (epërsinë) e Kushtetutës.[2]

Lart në Veri të Evropës, në **Danimarkë,** në këtë kohë ka ekzistuar instituti i kontrollit gjyqësor, mirëpo në praktikë shumë rrallë është zbatuar.

Në **Rumani**, si rast që përmendet shpesh në literaturë, në vitin 1912 një gjykatë e ulët e rrëzoi një ligj si jokushtetues pa pasur autorizimin e asnjë dispozite kushtetuese që do të lejonte një gjë të tillë, njëjtë siç kishte ndodhur me **Marbury vs Madison** (1803) në **SHBA**. Në mënyrë paradoksale, në literaturë thuhet se kjo qe bërë në konsultim me ekspertët francezë të drejtësisë, në një kohë kur vetë **Franca** ua mohonte gjykatave të veta një të drejtë të tillë, pra të drejtën që, përmes rrugës së kontrollit kushtetues të ligjeve, të sigurohet supremacia (epërsia) e kushtetutës.[3] Ky vendim i gjykatës së ulët rumune u përkrah nga **Gjykata e Kasacionit** (**GJKasR**), kurse më 1923, Kushtetuta e njohu rolin e gjyqësorit rumun për të kryer kontrollin kushtetues të ligjeve. Kjo ngeli e tillë edhe në Kushtetutën e vitit, e cila konfirmoi të drejtën të gjyqësorit rumun, mirëpo vetëm në favor të **GJKasR** dhe atë me efekt **inter partes**, pra me efekt vetëm për procedurën konkrete dhe jo **erga omnes** ndaj çdo rasti për të ardhmen.

Ngritja e autoritarizmit në **Evropë** në mes të dy luftërave botërore shkaktoi ngecje në zhvillim të gjyqësisë kushtetuese dhe të kontrollit kushtetues në përgjithësi. Vetëm vitet e para pas **Luftës së Parë Botërore** panë një sukses të kufizuar në sferën e kontrollit të legjitimitetit kushtetues të ligjeve, si në teori ashtu dhe në praktikë. Kur flitet për teorinë, pashmangshmërisht vjen në shprehje debati i parë i cekur më sipër në mes të **H. Kelsen** dhe **K. Shmit**, i cili gjerësisht jepet në vijim për shkak të ndikimit të thellë që ka pasur në formësimin e gjyqësisë kushtetuese evropiane. Në praktikë, ndërkaq, mund të thuhet se në këtë fazë ka pasur një rezistencë evropiane ndaj kontrollit gjyqësor të legjitimitetit kushtetues të ligjeve. Çekosllovakia në shkurt, kurse **Austria** në tetor të vitit 1920, ishin vendet që bënë eksperimentin e parë me gjyqësinë kushtetuese kelseniane, gjyqësi që ushtrohet nga një gjykatë me juridiksion të veçantë kushtetues dhe që nuk ka natyrën e gjykatave të rregullta të juridiksionit të përgjithshëm (penal, civil dhe administrativ). Në këtë vit, pra më 1920, këto dy vende themeluan gjykatat e para kushtetuese (dhe të vetmet në mes dy luftërave), të modeluara sipas modelit që sot quhet model **evropian/kelsenian**.

Tragjedia e Luftës së Dytë Botërore e gjeti botën të interesuar në lëmin e gjyqësisë kushtetuese dhe të institutit të kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë së ligjeve vetëm edhe në dy raste të tjera dhe atë

---

2 Epaminondas Spiliotopoulos, "Judicial Review of Legislative Acts in Greece". *Temple Law Quarterly* Vol. 56 No. 2 (1983) fq. 463, 471-472.

3 Herman Schwartz, *The Struggle for Constitutional Justice in Post-Communist Europe* (The University of Chicago Press: Chicago, 200) fq. 17.

jashtë kontinentit evropian. I pari rast ka të bëjë me **Kubën**, kurse i dyti me **Egjiptin**. T'i sqarojmë këto dy raste në vijim.

Kuba, ka qenë vendi i parë jashtë Evropës që me Kushtetutën e vitit 1940, ka bërë themelimin e gjykatës me juridiksion të veçantë kushtetues. Ajo gjykatë u quajt **Tribunali i Garancioneve Kushtetuese dhe Sociale (TGKS)**, dhe u themelua brenda **Gjykatës Supreme të Kubës (GJSKu)**, si një trup i veçantë i saj. Sistemi i gjyqësisë kushtetuese që ushtrohet nga një gjykatë e ndarë me juridiksion të veçantë kushtetues për kontroll të legjitimitetit kushtetues të ligjeve dhe akteve të tjera juridike nuk arriti të krijohej më në asnjë vend tjetër deri pas mbarimit të **Luftës së Dytë Botërore**, kur nisi vala e parë, përkatësisht vala e dytë (nëse merret parasysh themelimi i gjykatave kushtetuese në Çekosllovaki dhe **Austri** më 1920). Rasti i **Kubës** paraqet një kuriozitet historik në mes të tragjedisë së përmasave botërore që po ndodhte në atë kohë në mbarë botën. Si i tillë, ky rast sikur meriton një shtjellim doktrinar me qëllim të zbulimit të shkaqeve dhe arsyeve reale të lindjes në një kohë të tillë. Trajtimi i këtyre aspekteve më në detaje, megjithatë, tejkalon caqet e këtij libri ashtu që nuk do të mund të ndalojmë më gjatë me këtë rast.[4]

Zakonisht periodizimet e zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese të modelit **evropian/kelsenian** nisin me vitin 1945 e tutje, duke i dalluar tri faza. Këtë periodizim e kemi ndjekur edhe në këtë libër.

Na duket që ka rëndësi sërish të flasim për disa prej aspekteve teorike dhe praktike të gjyqësisë kushtetuese dhe të kontrollit kushtetues evropian, nisur nga fakti se në **Evropë**, më shumë se çdo kund tjetër, është vërejtur rëndësia sublime e themelimit të institucionit të gjyqësisë kushtetuese dhe ushtrimit të kontrollit gjyqësor në një formë apo tjetër me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së kushtetutave nacionale kundrejt akteve juridike dhe praktikave jo kushtetuese. Rëndësia e kultivimit intensiv të gjyqësisë kushtetuese nuk ka ndodhur në një vakum intelektual. Përkundrazi, kësaj i ka paraprirë një diskurs i fuqishëm dhe një debat që personifikohet me emrat e dy kolosëve të dijes juridike, **H. Kelsen** dhe **K. Shmit** respektivisht.

H. Kelsen, një ndër mendimtarët më të mëdhenj të drejtësisë në shekullin e kaluar, ka qenë hartuesi kryesor i **Kushtetutës së Austrisë** (KAu) të vitit 1920. Njëjtë sikur **John Marshall**, edhe ky besonte se kushtetutat duhet të trajtoheshin si tërësi normash juridike më superiore, më të larta, se normat ligjore dhe normat tjera juridike, ashtu që, si të tilla, duheshin vënë në jetë, pra si norma superiore, më të larta se legjislacioni i zakonshëm dhe normat e tjera juridike. Vënia në jetë e normave kushtetuese përmes gjyqësorit të rregullt, megjithatë, kishte kohë që nuk përbënte një opsion serioz. Për këtë shkak **H. Kelsen** u rreshtua me **liberalët e Frankfurtit**, të cilët qysh më 1849 qenë angazhuar për krijimin e një gjykatë të specializuar, të ndarë nga gjyqësori i rregullt, e cila do të monitoronte legjislacionin dhe do të kishte të drejtën e anulimit në rastet e mospërputhjes së tij me kushtetutën nacionale. Për të kundërshtuar argumentet që atëbotë thoshin se gjykata kushtetuese do të imponohej si një zëvendësim i politikëbërësit, kompetencë që i takon vetëm ligjvënësit, **H. Kelsen** qëllimisht e la jashtë **KAu** kapitullin mbi të drejtat dhe liritë njerëzore. Në fakt, në këtë periudhë, vetëm **KV** kishte futur në tekstin e saj një kapitull të veçantë mbi liritë dhe të drejtat individuale, kapitullin e dytë famoz, të cilin **K. Shmit** e ka cilësuar me përbuzje si kushtetutën e dytë të **Gjermanisë**.

Në vijim si më sipër, Kushtetuta, e draftuar me ndihmën e madhe të **H. Kelsen**, parashikoi themelimin e **Gjykatës Kushtetuese të Austrisë** (**GJKAu**), duke kufizuar rolin e saj vetëm në suazat e **ligjvënësit negativ** në përjashtim të çdo ideje për juridiksionin në sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut. Si palë të autorizuara, Kushtetuta njohu gjykatat e rregullta, të cilat kishin të drejtë të referonin çdo ligj austriak për kontroll kushtetues në rastet kur dyshonin në kushtetutshmërinë e tij. Si palë të autorizuara me

[4] Për një shtjellim elokuent të shkaqeve dhe arsyeve reale të lindjes së konstitucionalizmit kuban në këtë kohë dhe të gjyqësisë kushteuese me juridiksion të ndarë, shih më shumë në Michael B. Wise, "Cuba and Judicial Review". *Southwestern Journal of Law and Trade in the the Americas* Vol. 7 No. 2 (2000) fq. 247-266 (ku autori diskuton rikthimin e traditës kubaneze të kontrollit kushtetues që ka ekzistuar në gjysmën e parë të shekullit '20-të, daljen nga izolimi dhe pajtimin me SHBA-në, si dhe demokratizimin si arsye për rifutjen e kontrollit kushtetues në vend).

juridiksion origjinal, u cilësuan edhe organet e caktuara shtetërore në nivel qendror dhe lokal (kur ishte fjala për realizimin e të drejtave të njësive përbërëse të administratës lokale austriake).

Këtë aktivitet të mbrojtjes së superemacisë (epërsisë) së kushtetutës, **H. Kelsen** e ka cilësuar, për herë të parë, si **mbrojtje juridiksionale**. Më këtë nënkuptohet mbrojtja e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës që kryhet si pasojë e ekzistimit në tekstin kushtetues të dispozitave të veçanta shprehimore mbi juridiksionin kushtetues të gjykatës kushtetuese, e cila vepron e ndarë nga gjyqësori i rregullt. Ky juridiksion i specializuar dhe i veçantë kushtetues i përcaktuar qartë me tekstin kushtetues e dallon gjykatën kushtetues nga gjyqësori i rregullt. Për lexuesin jo gjerman, ai këto pikëpamje i ka bërë të qarta në një shkrim autorial në vitin tanimë të largët 1928,[5] kurse për lexuesin gjerman, ato qenë bërë të qarta në polemikën e tij me **K. Shmit**, të cilën e trajtojmë në seksionin në vijim.

Austria ishte e para që parashikoi themelimin e një gjykate të ndarë kushtetuese, mirëpo themelimi i gjykatës së parë kushtetuese në **Evropë** ka ndodhur në një vend tjetër: në shkurt të vitit 1920 u bë themelimi i **Gjykatës Kushtetuese të Çekosllovakisë (GJKÇK)**. Gjatë tërë historisë së saj tetëmbëdhjetëvjeçare, kjo Gjykatë ka bërë vlerësimin e legjitimitetit kushtetues të vetëm dy ligjeve. Pas shtypjes në gjak të **Pranverës së Pragës** (1968), komunistët çekosllovakë triumfues nxorën një amendament kushtetues që parashikonte restaurimin e Gjykatës së vitit 1920, por pa sukses. Ky vend u desh të presë deri në vitin1991, për të themeluar një gjykatë kushtetuese, e cila më pastaj u nda në dysh pas ndarjes së Çekosllovakisë dhe themelimin e shteteve të pavarura të Çekisë dhe **Sllovakisë**.[6]

GJKAu, e themeluar në tetor të vitit 1920, në vijim të vënies në jetë të idesë kelseniane mbi gjyqësinë e ndarë kushtetuese nga gjyqësori i rregullt, ka qenë shumë e ngjashme me **GJKÇK**, por me një juridiksion shumë më të gjerë: ajo kishte në juridiksion të vetin për të vendosur jo vetëm mbi legjitimitetin kushtetues të ligjeve, por edhe lidhur me çështjet e tjera kushtetuese që buronin nga struktura federative e shtetit të ri austriak, i themeluar nga rrënojat e perandorisë Austro-Hungareze. Përveç këtij juridiksioni, ajo kishte të drejtë për të vendosur edhe mbi legjitimitetin kushtetues të zgjedhjeve, referendumeve, si dhe për akuzat kundër zyrtarëve të lartë shtetërorë. Pas reformës kushtetuese të vitit 1929, **Austria** ua njohu edhe njësive administrative lokale, të quajtura **lander**, të drejtën e fillimit të procedurës pranë **GJKAu**, si dhe të drejtën e referimit në te të ligjeve të dyshuara si antikushtetuese nga ana e gjykatave më të larta të sistemit të rregullt gjyqësor austriak (**kontrolli incidental**). Diçka e tillë nuk ka ekzistuar në rastin e Çekosllovakisë në mes të dy luftërave botërore.

Gjermania e Vajmarit po ashtu ka eksperimentuar me kontrollin gjyqësor të legjitimitetit kushtetues të ligjeve dhe akteve të tjera juridike. Përgjatë viteve 1919-1933, **KV** ka njohur kompetencën ekskluzive të gjykatave gjermane, përfshirë këtu **Gjykatën Shtetërore të Rajhut**, e njohur si ***Staatsgerichtshof*,** për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kushtetuese, si dhe për thirrjen në përgjegjësi (**impeachment)**, të shefit të shtetit të ri gjerman, **Presidentit të Rajhut**.

Nenet 13, 15 dhe 19 [Rajhu dhe Shtetet Anëtare] të **KV** flisnin për mosmarrëveshjet kushtetuese dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre. Mosmarrëveshjet e tilla mund të lindnin në mes të njësive autonome shteteve anëtare, **lander**, si dhe në mes tyre dhe **Rajhut** gjerman. Për mosmarrëveshjet e para, kompetenca i takonte ***Staatsgerichtshof*** -it, kurse për mosmarrëveshjet e llojit të dytë kompetent ishin gjykatat e Rajhut me kompetencë konkrete për rastin.

Dispozitat e **KV** lidhur me thirrjen në përgjegjësi penale-kushtetuese (**impeachment**) të **Presidentit të Rajhut** kanë qenë të njëjta me dispozitat e **KAu**. Largimi nga detyra e Presidentit mund të bëhej përmes një referendumi të nisur nga ana e **Rajhstag-** ut, thuhej në nenin 43 [Presidenti i Rajhut dhe Qeveria] i Kushtetutës. Po ashtu, ky organ ka pasur të drejtën e **impeachement**-it të Presidentit para ***Staats-***

---

5 Hans Kelsen, "La garantie juridictionnelle de la constitution (La justice constitutionnelle)". *Revue du droit public et de la science politique en France et a l'etranger* XXXV (Librarie General de Droit et de Jurisprudence, Paris 1928).

6 Herman Schwartz, *The Struggle for Constitutional Justice in Post-Communist Europe*, fq. 18 dhe 252 (fusnota nr. 38).

gerichtshof*,** një gjykatë kjo e themeluar në bazë të nenit 8 [Sistemi i Drejtësisë] të **KV**, me kompetencë ekzkluzive për të zgjidhur mosmarrëveshjet në mes të organeve shtetërore të Rajhut gjerman. Para ***Staatsgerichtshof*, mund të nisej procedura e thirrjes në përgjegjësi të shefit të shtetit gjerman* vetëm nëse flitej për shkeljen me dashje të ligjeve gjermane nga ana e tij/saj.

Nuk ka qenë Evropa vendi i vetëm që ka shfaqur interesim për një mekanizëm gjyqësor me qëllim të sigurimit të supremacisë së kushtetutës, siç e kemi parë më sipër dhe në kapitullin pararendës. Për më tepër, marrë historikisht, në vendet e **Amerikës Latine** gjyqësia dhe kontrolli kushtetues, gjatë shekujve formativë të gjyqësisë kushtetuese që diskutohen këtu, kanë pasur forma të ndryshme të manifestimit. Shtjellimit dhe paraqitjes së këtyre formave iu kthehemi në vijim. Kështu ka qenë edhe me Evropën dhe fillet e saj të gjyqësisë kushtetuese, që nisin me kontrollin e natyrës jo juridiksionale.

Në fillim, kontrolli kushtetues ka qenë **kontroll politik** i legjitimitetit kushtetues të ligjeve dhe akteve të tjera juridike. Kjo shpjegohet me rrethanën historike të kolonizimit të këtyre vendeve nga **Spanja** dhe fuqitë tjera evropiane. Në parim, vendet anglofone u ndikuan nga sistemi britanik i të drejtës së përgjithshme (**common law**), kurse vendet tjera nën sundimin kolonial spanjoll dhe portugez ndoqën rrugën e sistemit evropian kontinental të së drejtës. Përtej kësaj nuk duhen kërkuar ligjshmëri të tjera në zhvillimin e gjyqësisë kushtetuese në **Amerikën Latine**. Edhe kjo ligjshmëri duhet marrë me shumë kujdes sepse, siç do të vërehet në shtjellimet e mëposhtme, nga mesi i shekullit XIX vendet e këtij kontinenti nisin të manifestojnë specifika tërësisht të veçanta që nuk lidhen me asnjërin sistem të së drejtës, por që më shumë shfaqen si reflektim i rrethanave specifike ekzistuese në këto vende. Ajo çka ngelet konstante, megjithatë, konsiston në faktin se **kontrolli kushtetues politik** u ngjiz në fillim, pas fitimit të pavarësisë së këtyre vendeve, si pasojë e të kaluarës koloniale, mirëpo më vonë ai u transformua në sisteme të ndryshme, në vartësi të nevojave nacionale të secilit vend.

Në këtë transformim, si **Evropa** ashtu dhe **SHBA** me sistemet e tyre të kontrollit kushtetues luajtën një rol të caktuar. Juridiksionet kushtetuese, qoftë të gjyqësorit të rregullt, të gjykatave të larta (supreme) të drejtësisë të veshura me juridiksion në çështjet kushtetuese, si dhe juridiksionet e gjykatave të mëvonshme kushtetuese latino-amerikane, në mënyrë të dukshme i manifestojnë rrethanat specifike që kanë ekzistuar në këto vende gjatë shekujve formativ 19-të dhe 20-të (deri më 1945). Këto rrethana kanë imponuar zgjidhjet specifike dhe konkrete në këto vende. Sidoqoftë, kjo përzgjedhje gjithnjë ka pasur një qëllim primar: ruajtjen e supremacisë (epërsisë) së tekstit kushtetues dhe rendit objektiv të bazuar në te në këto vende.

Në mesin e shekullit XIX ka ndodhur pika e kthesës në lindjen e kontrollit gjyqësor të kontrollit të legjitimitetit kushtetues të ligjeve në Amerikën Latine. Kjo për faktin se në shumicën e vendeve të kësaj pjese të botës u fut sistemi gjyqësor i kontrollit të legjitimitetit kushtetues të ligjeve,[7] i cili ishte i njëjtë me idenë amerikane, pra që të sigurohet supremacia (epërsia) e kushtetutës. Në kontekstin latino-amerikan, megjithatë, instituti i kontrollit kushtetues kishte cilësi tërësisht të tjera nga kontrolli kushtetues amerikan. Në një pjesë bukur të madhe të vendeve latino-amerikane zgjodhën sistemin e centralizuar, ku gjykatat supreme të drejtësisë, në kuadër të juridiksionit të tyre posedonin të drejtën e kontrollit kushtetues të ligjeve, si dhe të drejtën për anulimin e tyre me efekt **erga omnes.**[8] Këtë e diskutuam në kapitullin e mëparshëm kur folëm për këtë lloj të gjyqësisë kushtetuese dhe emërtimet institucionale afërsisht të njëjta të organeve që ushtronin këtë juridiksion kushtetues. Në disa vende të tjera të **Amerikës Latine** u përqafua sistemi i decentralizuar i kontrollit kushtetues, sipas modelit amerikan, ku të gjitha gjykatat e rregullta dhe të gjithë gjyqtarët vishen me autorizime të kontrollit kushtetues. Në këtë sistem, gjatë zgjidhjes së rasteve dhe mosmarrëveshjeve konkrete të natyrës civile, penale apo administrative gjyqtarët dhe gjykatat kanë kompetencë që të bëjnë kontrollin kushtetues të ligjeve. Kjo kompetencë nuk buronte

[7] Roberta Bile, "La guistizia costituzionale in America Latina". Në Luca Mezzetti (ed.), *SISTEMI E MODELLI DI GUISTIZIA COSTITUZIONALE* (CEDAM: Padova, 2009) fq. 482-484.

[8] Në këtë grup të vendeve hyjnë Brazili, Bolivia, Kolumbia, Kosta Rika, Kili, Republika Dominikane, Ekvadori, El Salvadori, Guatemala, Hondurasi, Meksiko, Nikaragua, Panama, Paraguaji, Urugvaji, dhe Venezuela.

domosdo nga kushtetuta nacionale. Në disa vende ai ishte rezultat i praktikës së përsëritur gjyqësore. Edhe këtë sistem të gjyqësisë kushtetuese në këtë pjesë të botës e kemi dhënë në kapitullin pararendës. Aktualisht është më i pakët se sistemi i mësipërm i kontrollit të centralizuar përmes juridiksionit të posaçëm të dhënë gjykatave supreme të drejtësisë në vend. Pas tij vijnë vendet që kanë gjykatë të ndarë kushtetuese sipas modelit **evropian/kelsenian**.

Megjithatë, historia na tregon që gjendja aktuale në Amerikën Latine nuk ka nisur me sistemin e juridiksionit të centralizuar që ushtrohet nga një gjykatë më e lartë në vend, së bashku me juridiksionin e përgjithshëm që ushtrojnë këto gjykata: sistemi më i vjetër, i cili ka filluar në **SHBA** në vitin 1803 me rastin **Marbury vs Madison**, në fillim të shekullit XIX, u shpërnda nëpër shumë vende të Amerikës Latine, si në **Argjentinë**, **Brazili**, **Kolumbi** dhe **Venezuela**. Afërsisht në kohën e njëjtë, ky sistem ishte përqafuar edhe ne disa vende në **Evropë**, në vendet si **Norvegjia**, **Danimarka**, **Suedia** dhe **Greqia**.

Në këtë sistem, siç dihet, nuk ndodhë anulimi i ligjeve, të cilat cilësohen si jo kushtetuese nga ana e gjykatës konkrete apo nga ana e gjyqtarit individual, por vetëm mënjanimi i tyre, lënia anash, moszbatimi i tyre në një rast dhe mosmarrëveshje konkrete. Në këtë sistem vendimi ka efekt **inter partes**, pra vetëm sa i përket rastit dhe mosmarrëveshjes konkrete. Efekti **inter partes**, megjithatë, zbutet dhe merr përmasa tjera si pasojë e doktrinës **stare decisis**, e cila ekziston në SHBA dhe në vendet tjera të sistemit anglo-sakson të së drejtës së përgjithshme (**common law)**. Ky sistem quhet sistemi i decentralizuar i kontrollit kushtetues. Më shumë për doktrinën **stare decisis** flasim në kapitullin 13- të të këtij libri, si dhe n ë kapitullin 15-të që trajton efektet dhe natyrën juridike të vendimeve.

Sistemi i centralizuar, pra sistemi në të cilin vetëm gjykata më e lartë e vendit ka juridiksion ekskluziv për të anuluar ligjet jo kushtetuese me efekt **erga omnes**, mund të ankorohet në një gjykatë të ndarë kushtetuese me juridiksionin ekskluziv të përcaktuar me kushtetutë për kontroll kushtetues të ligjeve dhe akteve tjera juridike, apo në një gjykatë më të lartë në nivel nacional, në gjykatën supreme, që funksionon në kuadër të sistemit të gjyqësorit të rregullt. Në rastin e parë, i cili ka filluar në Evropë në mes të dy luftërave botërore, sistemi i centralizuar cilësohet si kelsenian dhe në këtë kohë nuk ka ekzistuar në asnjë vend tjetër të **Amerikës Latine**. Në rastin e dytë, ndërkaq, fjala është për një sistem, i cili edhe sot është i përhapur në vendet e **Amerikës Latine**, ku gjykata më e lartë në nivel nacional, gjykata supreme si gjykatë e rregullt, ka juridiksion të përcaktuar me kushtetutë për kontrollin kushtetues të ligjeve dhe akteve tjera juridike. Efekti i vendimeve në këto raste është **erga omnes**.

Sistemi i përzier apo **hibrid** ekziston atëherë kur krahas gjykatës më të lartë në nivel nacional, gjykatës supreme si gjykatë e rregullt, e drejta e kontrollit gjyqësor të ligjeve dhe akteve tjera juridike u njihet edhe gjykatave dhe gjyqtarëve të niveleve më të ulëta. Efekti i vendimeve në këto raste është **inter partes**, sepse në të njëjtën kohë me juridiksionin e decentralizuar, me kushtetutë nacionale ruhet juridiksioni ekskluziv dhe i centralizuar i gjykatës më të lartë në nivel nacional, gjykatës supreme, për anulimin e ligjeve jo kushtetuese me efekt **erga omnes**.[9]

Krahas të drejtës për anulimin e ligjeve dhe akteve tjera jo kushtetuese me efekt **erga omnes**, juridiksioni, në disa prej këtyre vendeve latino-amerikane, ka konsistuar edhe në të drejtën e gjykatave të rregullta më të larta në vend për të vendosur në shkallë të parë dhe të fundit mbi kushtetutshmërinë e amendamenteve kushtetuese, konfliktin për kompetencë, si dhe të drejtën e juridiksionit kushtetues në çështje të tjera, siç janë referendumet, të drejtat e njeriut, kontrolli kushtetues i ndarjes së pushteteve (vertikal dhe horizontal), vlerësimi i përgjegjësisë kushtetuese dhe i përgjegjësisë tjetër të bartësve të lartë të funksioneve publike, dhe kështu me radhë.[10] Kjo është kështu edhe sot në shumicën e vendeve të **Amerikës Latine.**

---

[9] Ky është rasti me këto vende: **Brazili, Kolumbia, Republika Dominikane, Ekuadori, Guatemala, Meksiko, Nikaragua, Peru, Venezuela**. Ne Evropë janë **Portugalia**, e cila ka gjykatë të ndarë kushtetuese, dhe **Greqia**, e cila këtë detyrë të anulimit të ligjeve jo kushtetuese ia ka lënë Gjykatës Supreme, por, duke njohur edhe sistemin e decentralizuar në dobi të gjykatave tjera më të ulëta. Në Amerikën Veriore, **Kanada** po ashtu i takon sistemit të përzier apo hibrid të kontrollit kushtetues.

[10] Në këtë sistem bënin pjesë: **Bolivia, Kolumbia, Kili, Guatemala, Peru** dhe **Ekvadori.**

Gjatë shekujve formativë, vendet latino-amerikane kanë kaluar nëpër ndryshime të mëdha kur flitet për kontrollin kushtetues. Nga një sistem i kontrollit të pastër politik të kushtetutshmërisë, disa syresh aktualisht kanë përqafuar sisteme të kontrollit të kushtetutshmërisë që ngërthejnë përvojat e dy anëve të **Atlantikut**. Në disa raste të tjera, përvoja e **SHBA**-ve ka ngelur e pandryshuar dhe një model që është ndjekur deri më sot. Kjo u diskutua më lart kur u treguan tri sistemet e kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë që kanë ekzistuar deri në mes të dy luftërave botërore, me përjashtim të **Kubës**, e cila, më 1940, përqafoi idenë e kontrollit kushtetues **evropian/kelsenian**.

Në të gjitha rastet, megjithatë, vendet e këtij kontinenti kanë përqafuar sistemet e kontrollit kushtetues, të cilat më së miri iu kanë përshtatur rrethanave të tyre konkrete. E përbashkëta e tyre është se ndryshimet në fjalë kanë ndodhur gjithnjë duke synuar ruajtjen e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës nacionale dhe rendit objektiv të bazuar ne te. Kjo ka rëndësi të mbahet mend, përkatësisht fakti se kontrolli kushtetues, i cilitdo sistem qoftë ai, ka për qëllim primar ruajtjen e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës në nivel nacional. Kjo arrihet përmes juridiksionit të qartë të përcaktuar me kushtetutë apo përmes juridiksionit kushtetues të zhvilluar përmes praktikës gjyqësore. Parimi i epërsisë së kushtetutës përbën postulatin teorik dhe praktik më të rëndësishëm dhe më themelor të konstitucionalizmit modern. Ka disa mënyra për të siguruar epërsinë e një kushtetute, kryesore ndër të cilat është sigurimi i epërsisë përmes mekanizmit të gjyqësisë kushtetuese. Në fakt, në literaturë thuhet me plot të drejtë se gjyqësia kushtetuese ka lindur dhe legjitimohet përmes ushtrimit të detyrës së saj themelore-sigurimi i epërsisë së kushtetutës.[11] Kjo epërsi e kushtetutës sigurohet kryesisht përmes kontrollit të kushtetutshmërisë së akteve, veprimeve dhe mosveprimeve të pushtetit (qendror dhe atij lokal) dhe të autoriteteve tjera publike.

Në vijim do të shihet mënyra përmes së cilës është arritur qëllimi si më sipër në disa prej vendeve të **Amerikës Latine** përgjatë shekujve XVIII–XIX dhe deri pas rënies së komunizmit më 1989. Nga shtjellimet në vijim do të bëhet e qartë se kontrolli kushtetues i tipit amerikan nuk është diçka që i takon vetëm sistemit anglo-sakson të së drejtës së përgjithshme (**common law),** nisur nga fakti se në disa vende të **Amerikës Latine**, që i përkasin sistemit romak-kontinental, është përqafuar sistemi amerikan. Me fjalë tjera, në vijim do të shihet se nuk është sistemi i së drejtës përcaktues i modelit të kontrollit kushtetues, të cilin një vend e përqafon (**i centralizuar**, **i decentralizuar** dhe **i përzier** apo **hibrid**), por qëllimi që synohet të arrihet me te në kuadër të veçorive nacionale konkrete. Ai qëllim është, siç u cek më herët, pa marrë parasysh specifikat, ruajtja e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës dhe e rendit objektiv të bazuar në te. Të shohim këtë zhvillim sipas vendeve.

Bolivia ka qenë vendi që ka ndjekur në mënyrën më besnike përvojën franceze të kontrollit politik të kushtetutshmërisë së ligjeve të ankoruara në **Senatin Konservator**, i themeluar sipas Kushtetutës së Francës të 13 korrikut 1799. **Kushtetuta e Bolivisë e vitit 1826**, fryt i mendimit të **Simon Bolivar**-it, parashikonte kontrollin politik, i cili kishte për objekt verifikimin e pajtueshmërisë me kushtetutë të çdo akti të autoriteteve publike. Në këtë mënyrë, pranë **Dhomës së Përfaqësuesve** (**Tribunëve**) dhe **Dhomës së Senatorëve** qe krijuar një dhomë tjetër, **Dhoma e Censorëve**, e cila kishte për detyrë kryesore mbikëqyrjen nëse qeveria po e vinte në jetë kushtetutën dhe marrëveshjet publike. Nisur nga fakti se kontrolli ishte politik dhe zhvillohej në selinë e parlamentit, objekt kontrolli nuk ishin ligjet e parlamentit, të cilat cilësoheshin si të paprekshme, por mënyra e zbatimit të tyre. Vetëm më vonë, me **Kushtetutën e vitit 1831**, Këshilli i Shtetit evoluon në mënyrë graduale nga një organ legjislativ këshillues dhe informues në një komision që merret me mbikëqyrjen e cenimeve kushtetuese, pra jo më me mbikëqyrjen e mënyrës së zbatimit të ligjeve.[12]

---

[11] Pierre Brunet, "Le judge constitutionnel est – il un judge come les autres? Reflexions methodologiques sur la justice constitutionnelle". Në Constance Grewe et al. (eds.), *La notion de 'justice constitutionnelle* (Paris: Dalloz, 2005) fq. 115-135.

[12] Për historinë e ideve kushtetuese dhe praktikën boliviane, shih me shumë në Eduardo Rozo Acona e Paola Maffei, *LE COSTITUZIONI DELL'AMERICA LATINE. I PAESI DELLA COMMUNITA ANDINA* (G. GIAPPICHELLI EDITORE: TORINO, 2006) fq. 475-488; 407-425.

I ngjashëm me modelin bolivian ka qenë edhe modeli i **Brazilit**, i përcaktuar me Kushtetutën e vitit 1824. Në këtë model, një organi politik i besohet kontrolli kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjera juridike. Edhe në rastin e **Brazilit**, njëjtë si në rastin bolivian, modeli politik u ndikua fuqishëm, përveç përvojës franceze, nga idetë e **Benjamin Konstant**, njërit ndër ideatorët më të fuqishëm evropian të demokracisë përfaqësuese, ku nuk kishte rol për të luajtur për gjyqtarët. Sipas tij, gjyqtarëve asnjëherë nuk mund t'u besohej e drejta e kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve. Për këtë, ai u angazhua që legjislativi, përveç nxjerrjes së ligjeve, të paraqiste organin e vetëm me mundësi unike të interpretimit, pezullimit dhe revokimit të ligjeve. Kjo mundësi, për pasojë, i jepte të drejtë legjislativit që të imponohej si një organ unik i garantimit të kushtetutës nacionale. Këto ide nuk qenë pjesë e zgjidhjeve kushtetuese braziliane deri me ndryshimet kushtetuese të vitit 1834. Me kushtetutën e këtij viti parashihej që, përveç kontrollit politik të kushtetutshmërisë së ligjeve në nivel federal, të ketë edhe kontroll të decentralizuar në nivel provincial. Ky kontroll ishte i tipit preventiv dhe u jepte të drejtë guvernatorëve të provincave për të shikuar nëse ligjet e nxjerra cenonin të drejtat e provincave tjera braziliane apo të drejtat e përcaktuara me marrëveshje ndërkombëtare. Në rast të kundërshtimit nga ana e organit legjislativ provincial, qeveria ose asambleja e përgjithshme federale vendoste meritorisht mbi çështjen.

Ekuadori po ashtu përqafoi modelin politik të kontrollit kushtetues me **Kushtetutën e vitit 1851**. Këshilli i Shtetit ishte një organ, i cili, në kuadër të kompetencave të tij, kishte mbikëqyrjen e respektimit të kushtetutës dhe të ligjeve. Ky kontroll zhvillohej në dy faza: në fazën e parë bëhej një kërkesë direkte ndaj ekzekutivit për të mënjanuar cenimin e kushtetutës apo të ligjit dhe i cili, nëse nuk e mënjanonte të njëjtin, detyrohej që, në fazën e dytë, mbahej përgjegjës për mosbashkëpunim në largimin e cenimeve si më sipër.

Vendet tjera latine-amerikane që kanë përqafuar kontrollin politik të kushtetutshmërisë së ligjeve, kanë qenë **Kili** (deri në vitin 1925) dhe **Peru** (deri më 1979). Qasja e favorshme, përkatësisht përqafimi i kontrollit politik të kushtetutshmërisë në këto vende u përsërit më vonë. I tillë është rasti me **Kushtetutën e Bolivisë e vitit 1967**, e cila ia njihte Kongresit të drejtën e interpretimit të ligjeve me peshë kushtetuese,[13] dhe me **Kushtetutën e Perusë të vitit 1993**, e cila aktualisht ia njeh Kongresit të drejtën e mbikëqyrjes së respektimit të Kushtetutës.

Kontrolli kushtetues politik, i ndikuar kryesisht nga idetë dhe praktikat franceze të fundit të shekullit XIX, në rend të parë nga shtjellimet teorike të **Benjamin Konstan**, megjithatë nuk ka qenë model dominues në Amerikën Latine. Në **Meksikë** me **Kushtetutën e Shtetit Jukatan** të vitit 1841, u përqafua për herë të parë kontrolli gjyqësor i kushtetutshmërisë. Kjo kushtetutë futi në dispozitat e veta institutin e kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë së ligjeve, i njohur si **recurso de amparo** apo **jucio de amparo**. Arkitekt ideor i këtij instituti qe gjyqtari **Manuel Crescencio Rejon** (**Manuel Kreshencio Rejon: 1799-1849**) nga Jukatani, provincë që në atë kohë kërcënohej se do të pavarësohej nga Meksika. Ndikim të madh në lindjen e këtij instituti në Meksikë ka pasur **Aleks de Tokvil** (**Alexis de Tocqueville: 1805-1859**) dhe vepra e tij **Demokracia në Amerikë**, e cila, që nga viti 1837, nisi të përdorej gjerësisht nëpër qarqet intelektuale në Meksikë. Ky institut u parashikua edhe në **Kushtetutën e Meksikos të vitit 1847** dhe është ruajtur edhe në **Kushtetutën e vitit 1917**. Në të gjitha format e saj,[14] **amparo** ka pasur dhe ka për qëllim dy gjëra: e para, që përmes kontrollit gjyqësor të sigurohej mbrojtja e të drejtave dhe lirive të garantuara me kushtetutë, ligje dhe me konventa ndërkombëtare; dhe, e dyta, që përmes kontrollit gjyqësor të bëhej vlerësimi i kushtetutshmërisë së ligjeve meksikane në të gjitha nivelet, njëjtë si në **SHBA**,

---

13 Ibid., fq. 475-488.

14 Sipas Kushtetutës së **Meksikos,** si dhe praktikës shekullore të këtij vendi, amparao ka sot pesë forma: 1. amparo për mbrojtjen e lirisë personale kundër veprimit të shtetit (**amparo de libertad**); 2. amparo për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve (**amparo contra leyes**); 3. amparo gjyqësore apo lidhur me interpretimin gjyqësor të kushtetutshmërisë së ligjit ose të ligjshmërisë së vendimit gjyqësor (***recurso de casacion***); 4. amparo për kontroll gjyqësor të veprimit administrativ të shtetit (**amparo como contencioso-administrativo**)*;* dhe 5. amparo në çështjet bujqësore apo komunale që ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave të fshatarëve që mund të jenë prekur gjatë kryerjes së një reforme agrare (**amparo en materia agraria, ejidal y comunal**).

duke i fuqizuar gjyqtarët e rastit dhe mosmarrëveshjes konkrete që të mënjanojnë zbatimin e ligjeve, të cilat ata mund t'i konsideronin si jo kushtetuese. Në këtë drejtim ka një ngjashmëri me sistemin amerikan. Ideja e zbatimit të prototipit të SHBA-ve në sistemin meksikan, megjithatë, pësoi një ndryshim sa i përket forcës (efektit juridik) të **stare decisis**. Kjo u sqarua qysh në projektin e **Kushtetutës së Jukatanit të vitit 1840**, një vit para nxjerrjes së saj më 1841. Që atëherë u parashikua që **Gjykata Supreme e Drejtësisë në Meksikë** (**GJSDM**) do të kishte një tjetër qëndrim sa i përket fuqisë, efekteve juridike, të vendimeve gjyqësore në rastet tjera, **stare decisis**. Kjo u bë ashtu që u parashikua që një vendim gjyqësor i **GJSDM**, me qëllim që të fitojë cilësitë e stare decisis, ai duhej të përsëritej pesë herë dhe vetëm atëherë të konsiderohet i detyrueshëm për gjykatat dhe subjektet tjera të së drejtës. Kjo përbënte esencën e **stare decisis** *në sistemin meksikan të drejtësisë, gjë që ishte dallim* i madh me sistemin e **SHBA**-ve. Një hap i tillë, sidoqoftë, nuk e ndryshoi modelin meksikan të kontrollit gjyqësor, i cili ngeli një model unik i kontrollit të decentralizuar gjyqësor të kushtetutshmërisë, njëjtë si në **SHBA.**[15]

Kushtetuta e Venezuelës e vitit 1881 ka futur klauzolën mbi supremacinë (epërsinë) kushtetuese, njëjtë si në Kushtetutën e SHBA-së (1787), përkatësisht klauzolën mbi supremacinë (epërsinë) e burimeve të së drejtës kushtetuese ndaj akteve tjera të autoriteteve publike si dhe pavlefshmërinë e tyre akteve në rastet e mospajtimit me burimet e së drejtës kushtetuese. Kjo klauzolë ka pasur për pasojë veshjen e gjyqtarëve me pushtet për të shpallur si të pavlefshëm ligjet që mendohej se binin ndesh me Kushtetutën. Krahas kësaj, në **Venezuelë** ka ekzistuar edhe kontrolli politik i kushtetutshmërisë së ligjeve, i cili është kryer nga ana e Kongresit, por vetëm sa i përkiste ligjeve provinciale. Ky kontroll politik ishte i centralizuar në duart e Kongresit dhe ka mbizotëruar ndaj kontrollit gjyqësor deri në vitin 1821. Në këtë vit hyri në fuqi **Kushtetuta e Kolumbisë së Madhe**, e cila shkaktoi moszbatimin e Kushtetutës së vitit 1811, në ndërkohë që më pastaj Kushtetuta e 1858 parashikoi institucionin e **actio popularis**. Me këtë mjet, çdo qytetar venezuelas mund t'i drejtohej **Gjykatës Supreme të Drejtësisë** (**GJSDV**) për kontroll të kushtetutshmërisë së ligjeve provinciale. Që nga vitit 1864, me **actio popularis** mund të sfidoheshin edhe ligjet federale, krahas atyre provinciale, kurse Kodi i Procedurës Civile i vitit 1897 ua njohu të drejtën gjyqtarëve për moszbatim të ligjeve, të cilat i vlerësonin si jo kushtetuese gjatë kohës së zbatimit të tyre në një rast apo mosmarrëveshje konkrete. Me këtë zgjidhje juridike, **Venezuela** u bë vendi i parë që përqafoi modelin e **përzier** apo **hibrid** të kontrollit kushtetues. Kjo nënkuptonte që krahas **GJSDV**, secili gjyqtar i vendit kishte autorizim për moszbatim të ligjeve në rastet kur dyshonte në kushtetutshmërinë e tyre gjatë vendosjes për një rast apo mosmarrëveshje konkrete. Në praktikë, megjithatë, ka ardhur deri te moszbatimi konsistent i praktikës së mënjanimit apo lënies anash të ligjeve kushtetutshmëria e të cilave ishte vënë në dyshim nga ana e gjyqtarit konkret.

Guatemala, në mesin e kushtetutave që i përkasin asaj që atëherë quhej **Federata e Republikës së Amerikës Qendrore (FRAQ)**, duket të ketë qenë më e ndjeshmja sa i përket mbrojtjes së të drejtave të njeriut nga ana e autoriteteve shtetërore. Kushtetuta **FRAQ** e vitit 1835 kishte futur epërsinë e burimeve kushtetuese, kurse vetë **Guatemala** si pjesë e saj, kishte nxjerrë një deklaratë me karakter kushtetues mbi të drejtat dhe liritë individuale e kolektive të garantuara me Kushtetutë. Sipas kësaj deklarate, çdo akt që cenonte të drejtat kushtetuese, individuale apo kolektive, pa marrë parasysh formën apo burimin e aktit, konsiderohej i pavlefshëm. Vlen të theksohet se edhe në **Guatemalë** ka pasur shenja të kontrollit politik kushtetues, sipas të cilit gjyqtarët ishin të detyruar që ta përcillnin në Asamblenë e Guatemalës secilin ligj që cilësohej jo kushtetues. Asambleja më pastaj detyrohej që të bënte interpretimin autentik të tyre. Ky interpretim nuk i obligonte gjyqtarët, të cilët ruanin të drejtën e moszbatimit apo mënjanimit të ligjeve të tilla që ata i cilësonin si jo kushtetuese.

Në **Argjentinë**, po ashtu nën ndikimin e SHBA-ve, gjyqtarët ushtronin një kontroll difuz apo të decentralizuar të kushtetutshmërisë së ligjeve, krahas të drejtës së tyre për t'iu drejtuar Gjykatës

[15] Shih, po ashtu, edhe Elena Malfati, Saulle Panizza, Roberto Romboli, *GIUSTIZIA COSTITUZIONALE* (G. GIAPPICHELLI EDITORE: TORINO, 2013) fq. 19-20.

Supreme me mjetin e quajtur **kërkesë të jashtëzakonshme për jo kushtetutshmëri**. Kjo nuk ishte një mjet juridik i shkallës së tretë por një mekanizëm autonom i kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve.

Kushtetuta e Kolumbisë e vitit 1811 paraqet të rrallën në mesin e kushtetutave të vendeve të Amerikës Latine sepse njohu **actio popularis**, diçka e panjohur deri atëherë. Me këtë mjet çdo qytetar mund t'i drejtohej organeve të shtetit për të mbrojtur të drejtat dhe liritë kushtetuese pa pasur nevojë që të dëshmojë për cenimin e një të drejte subjektive, përkatësisht pa pasur nevojë që të dëshmojë se është i veshur me një interes personal juridik. Ky institut u prish me Kushtetutën e vitit 1812, për t'u rishfaqur sërish me Kushtetutën e vitit 1910.

Me **Kushtetutën e Kolumbisë** të vitit 1886, u parashikua edhe një institut i rëndësishëm i kontrollit kushtetues, i njohur me emrin **plan de veto.** Me këtë nënkuptohej procedura sipas së cilës në procesin e nxjerrjes së ligjeve, në dy faza, mund të vinte deri të vlerësimi i kushtetutshmërisë së ligjeve. Faza e parë ishte kur shefi i shtetit bënte një veto në draft-ligjin e miratuar, kurse, e dyta, ishte fazë gjyqësore dhe vinte në shprehje vetëm atëherë kur vetoja e shefit të shtetit ishte mbivotuar nga një shumicë e kualifikuar. Në këtë rast, kërkesa për vlerësim të kushtetutshmërisë së ligjit të votuar përmes një shumice të kualifikuar të Kongresit i drejtohej Gjykatës Supreme të Drejtësisë. Nëse Gjykata Supreme vlerësonte se ligji i vetuar nga shefi i shtetit ishte kushtetues, ky i fundit nuk gëzonte më të drejtën e ushtrimit të vetos tjetër. Një mekanizëm i ngjashëm i kontrollit kushtetues ka qenë i parashikuar në **Kushtetutën e Ekuadorit të vitit 1869.**

Ndër vendet, përvoja e të cilave ka dalluar dukshëm nga ajo e SHBA-ve, janë **Bolivia, Urugvaj**, **Panama** dhe **Kuba**. Kjo e fundit, siç u cek më sipër, në vitin 1940 formoi gjykatën e parë kushtetuese në Amerikën Latine. Përvoja kubane bazohej në përvojën e **Kolumbisë** dhe **Venezuelës.** Kjo u bë për shkak se, para formimit në Kubë të **TGKS**, kontrollin kushtetues e ka ushtruar vetë **GJSKU**. Ky kontroll, megjithatë, ka qenë shumë më i ndryshëm se praktika e SHBA-ve dhe atë për dy arsye: *e para*, kërkesa në **GJSKU** mund ushtrohej në mënyrë të drejtpërdrejtë, pra jo vetëm në rastet kur kërkesa lindte gjatë vendosjes së një rasti dhe mosmarrëveshje konkrete pranë një gjykate më të ulët; dhe, *e dyta*, nëse gjatë shqyrtimit të kërkesës, **GJSKU** vlerësonte se ekzistonte një normë jo kushtetuese, atëherë vetë ajo e bënte anulimin e aktit, pra jo vetëm moszbatimin e tij për të ardhmen.[16]

I themeluar në kuadër të **GJSKu**, bazuar në nenet 182 dhe 183 ["Tribunali i Garancioneve Kushtetuese dhe Sociale"] të **Kushtetutës së Kubës** të vitit 1940, **TGKS** kishte juridiksion të ndarë dhe ekskluzivisht kushtetues me qëllim të ruajtjes dhe sigurimit të supremacisë (epërsisë) së kushtetutës ndaj ligjeve dhe çdo akti tjetër juridik në Kubë. Ai mund të vihej në lëvizje me kërkesë të organeve të pushtetit qendror, të gjyqtarëve dhe gjykatave më të ulëta, universiteteve etj. Vendimi kishte efekt të përgjithshëm, **erga omnes**. Përveç kësaj, **TGKS** mund të vihej në lëvizje edhe përmes **actio popularis**, e cila ushtrohej nga qytetarët, të cilët mendonin si iu ishin cenuar të drejtat e tyre kushtetuese, si dhe nga një grup prej 25 qytetarësh të organizuar për ta ushtruar **actio popularis**, pa marrë parasysh nëse vetë kishin qenë viktima të cenimeve të drejtave të tyre të garantuara me kushtetutë.[17]

Me një dekretligj të 1857, që rregullonte organizimin e gjyqësisë në **Bolivi**, Gjykatës Supreme iu njoh roli i organit të kontrollit të legjitimitetit kushtetues të ligjeve. Ky kontroll konsistonte në veçanti në të drejtën e deklarimit përfundimtar mbi kushtetutshmërinë e ligjeve në të gjitha çështjet civile, të cilat ishin duke u vendosur pranë një gjykate më të ulët. U mor vesh, kjo nënkuptonte se vendosja e tillë varej nga kushtetutshmëria e ligjeve, të cilat duheshin zbatuar në çështjet konkrete civile. Nga viti 1878 kompetenca e kontrollit të kushtetutshmërisë së akteve legjislative u zgjerua, duke përfshirë çdo akt juridik të nxjerrë nga autoritetet publike.

---

16 Michael B. Wise, "Cuba and Judicial Review", 249-252.

17 Ibid. fq. 253- 255 (ku komentohen juridiksioni dhe palët e autorizuara për të vënë në lëvizje **TGKS**).

Edhe **Kushtetuta e Urugvajt e vitit 1934,** ia ka njohur Gjykatës Supreme të drejtën origjinale dhe eksk-luzive të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve. Me reformën kushtetuese të vitit 1954, u parashikua që subjektet ligjërisht të autorizuara mund t'i drejtoheshin kësaj Gjykate në mënyrë të drejtpërdrejtë, krahas kërkesës për kontroll incidental, ku kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjit që duhej zbatuar nga gjykata më e ulët me rastin e vendosjes për një rast apo mosmarrëveshje konkrete paraqitej si një kusht i domosdoshëm për vendosje meritore.

Rendi panamez inspirohej nga **Kushtetuta e Kolumbisë** e vitit 1910. E nxjerrë më 1941, **Kushtetuta e Panamasë** parashikonte të drejtën e Gjykatës Supreme për të mbrojtur integritetin e kushtetutës. Në mënyrë definitive dhe meritore, Gjykata kishte të drejtën e deklarimit lidhur me kushtetutshmërinë e ligjeve, dekreteve, rregulloreve dhe vendimeve tjera të autoriteteve publike. Procedura vihej në lëvizje me kërkesë të çdo qytetari, **actio popularis**, kurse vendimi lidhur me rastin kishte efekte **erga omnes**, gjë që flet për llojin e centralizuar të kontrollit kushtetues në këtë vend. Ky kontroll i centralizuar, megjithatë, ushtrohej nga Gjykata Supreme sepse akoma në këtë periudhë në Amerikën Latine nuk ka ekzistuar gjyqësia kushtetuese kelseniane.

Evropa dhe Amerika Latine nuk kanë qenë të vetmet në gjyqësi kushtetuese dhe në përsiatjet teorike dhe praktike për instalimin e saj. Në **vendet arabe** ka pasur përpjekje, sado që në fazat e mëvonshme të zhvillimit të këtyre vendeve. Kështu, kontrolli gjyqësor i kushtetutshmërisë së ligjeve ka qenë fare i pavërejtur në mes dy luftërave botërore, në ndërkohë që fare nuk ka ekzistuar as si ide përgjatë tërë shekullit XVIII. Kjo shpjegohet me statusin e tyre kolonial apo gjysmë kolonial në mes të dy luftërave botërore dhe gjatë tërë shekullit XVIII. Ka qenë **Kushtetuta e Irakut e vitit 1925**, ajo e cila për herë të parë ka përmendur mundësinë e kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë së ligjeve, ani se në praktikë nuk ka pasur ndonjë efekt. Këtë ide, për herë të parë e ka vënë në praktikë një vend tjetër arab, **Egjipti**: në praktikën e tij gjyqësore më **1941,** është shënuar një rast i një gjykate të ulët që ka eksperimentuar me instalimin e institutit të kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë së ligjeve, në tërësi jashtë përcaktimit kushtetues. **Kushtetuta e Egjiptit (**1923), e cila ka qenë në fuqi më 1941, nuk ka thënë asnjë fjalë për mundësinë e kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë së ligjeve.[18]

Me mbarimin e **Luftës së Dytë Botërore** dhe, më pastaj, me rrënimin e komunizmit më 1989 dhe mbarimin e **Luftës së Ftohët**, vendet arabe dhe vendet e tjera islamike instaluan në kushtetutat e veta modelin **evropian/kelsenian**, krahas tri modeleve tjera të kontrollit të legjitimitetit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve tjera të pushtetit publik, të cilat u diskutuan më sipër (**modeli i decentralizuar**, **modeli i centralizuar** përmes gjykatës më të lartë në vend apo gjykatës supreme, si dhe **modeli i përzier** apo **hibrid**).

3.2. Periudha në mes të dy luftërave botërore: debati Kelsen – Shmit

Debati i njohur në mes të **H. Kelsen** dhe **K. Shmit**, i zhvilluar në mes të dy luftërave botërore, ka vënë themelet teorike dhe praktike të gjyqësisë kushtetuese. Me këtë debat janë qartësuar vijat e përgjithshme të gjyqësisë kushtetuese juridiksionale dhe të centralizuar. Kjo sot cilësohet si **gjyqësi kushtetuese evropiane/kelseniane**, për ta dalluar nga gjyqësia e centralizuar kushtetuese, e cila ushtrohet në kuadër të gjyqësorit të rregullt, përkatësisht nga gjykatat më të larta ne vend, nga gjykatat supreme. Kjo u diskutua më herët në rastet e Amerikës Latine.

Në këtë lloj të gjyqësisë kushtetuese, çdoherë ekziston një gjykatë kushtetuese e ndarë nga gjyqësori i rregullt dhe që posedon juridiksion të qartë dhe të përcaktuar në mënyrë taksative me kushtetutë nacionale, krejt kjo me qëllim parësor ruajtjen dhe garantimin e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës kundrejt legjislacionit tjetër të zakonshëm. U mor vesh, ajo që sot quhet gjyqësi **evropiane/kelseniane**, ka pësuar ndryshime të mëdha si në formë ashtu dhe në përmbajtje, mirëpo ideja ngelet e njëjtë: ruajtja e suprem-

[18] Nathan J. Brown, *Constitutions in a Nonconstitutional World. Arab Basic Law and the Prospects for Accountable Government* (State University of New York Press: New York, 2002) fq. 148-150.

acisë (epërsisë) së kushtetutës kundrejt legjislacionit të zakonshëm përmes një gjykate të specializuar si organ i veçantë që me kushtetutë e ka qartë dhe në mënyre taksative të përcaktuar juridiksionin e vet kushtetues, duke operuar i ndarë dhe jashtë juridiksionit të gjyqësorit të rregullt. Këtë do ta shohim gjatë shtjellimeve tona në këtë kapitull dhe në kapitujt tjerë.

Para se të kalojmë tutje në debatin konkret në mes të dy kolosëve të dijes së shekullit që e lamë pas, është mirë të theksohet se idetë e tyre kanë ardhur si rezultat i ideve të dijetarëve të tjerë që, me përsiatjet e tyre të mëhershme, kanë trasuar rrugën për lindjen e ideve të gjyqësisë kushtetuese evropiane/kelzeniane. Idetë nuk lindin papritmas, por si rezultat i grumbullimit të dijes dhe përvojës njerëzore nga e kaluara. Edhe gjyqësia kushtetuese evropiane/kelzeniane i ka pasur idetë e saj pararendëse, të grumbulluara përgjatë historisë. Këto ide i gjejmë te dy mendimtarë më me ndikim në mendimin juridik bashkëkohor të proveniencës liberale perëndimore: **Xhorxh Jellinek** (**Geork Jellinek: 1851-1911**) dhe **Leon Digi** (**Leon Duguit: 1859-1928**).

Fillimi i shekullit njëzet u përndritësua me veprën **Allgemeine Staatslehre** (1990) të **Xhorxh Jellinekut**. Në këtë vepër flitet me miradije për kontrollin gjyqësor të kushtetutshmërisë së ligjeve. Aty ravijëzohen tri lloje të garancioneve në të drejtën publike: **garancionet shoqërore**, **garancionet politike** dhe, së fundi, **garancionet juridike**. Si **garancione shoqërore** cilësohen ato forca të mëdha shoqërore, si feja, zakonet, morali shoqëror, përkatësisht tërësia e forcave civile, e interesave dhe e organizimeve të prodhuara nga këto forca. Këto forca përcaktojnë me një fuqi të madhe jetën reale të institucioneve shtetërore dhe historinë e shtetit, duke shërbyer si frenues ndaj arbitrariteteve dhe abstraksioneve dhe kompromiseve juridike. Ngjashëm me garancionet shoqërore janë **garancionet politike**, të cilat manifestohen më së miri në mënyrën se si është ndarë pushteti në një shtet. Garancionet politike nuk kanë besueshmëri të madhe si pasojë e mundësisë permanente për të prodhuar rezultate tjera nga ato që parashikohen. Kjo ndodhë sepse pushteti prodhon arbitraritet, korrupsion dhe mundësi për obstruksionizëm.

Të vetmet në të cilat mund të mbështetet shoqëria e dhënë në një mënyrë unike janë **garancionet juridike**. Këto garancione, sipas **Jellinekut** ndahen në dy grupe: granacionet që kanë për qëllim mbrojtjen e rendit objektiv, dhe garancionet që kanë për qëllim mbrojtjen e sferës juridike individuale. Të kuptuara kësisoj, garancionet juridike kanë edhe institucionet e veta, konstaton **Jellinek**, përmes të cilave bëhet realizimi i tyre në jetë: 1. **institucioni i kontrollit**; 2. **përgjegjësia individuale**; 3. **Juridiksioni;** dhe, së fundi 4. **mjetet juridike**.

Me theksimin e juridiksionit si një funksion shtetëror që ka për qëllim mbrojtjen e të drejtës në përgjithësi, autori ka paralajmëruar zhvillimet teorike të viteve njëzet të shekullit të kaluar, të shpalosura në debatin **Kelsen – Shmit**, zhvillime të cilat kanë të bëjnë kryesisht me kontrollin e centralizuar të kushtetutshmërisë së ligjeve. Me juridiksion nënkuptohet jo vetëm juridiksioni i gjyqësorit të rregullt, por edhe ai që është i ndarë nga juridiksioni i gjyqësorit të rregullt. Me rëndësi është përmbajtja, thotë **Jellinek**, e cila konsiston në të drejtën e këtij juridiksioni të ndarë për të vlerësuar nëse ligjet dhe aktet më të ulëta kanë vlerë juridike. Ky juridiksion, i kuptuar në këtë mënyrë, përbën një garancion të rëndësishëm të së drejtës publike. Kjo sepse me te vetë shteti ka të drejtë që të vejë në lëvizje juridiksionin në fjalë, si një juridiksion i ndarë kushtetues, me qëllim të vendosjes së çështjeve nga e drejta objektive publike, siç janë, bie fjala, çështjet e vendosjes për konfliktin për kompetencë.

Me shtrirjen e juridiksionit në lëmin e së drejtës publike është bërë një ndër arritjet më të mëdha në strukturën e shtetit modern të shekullit XIX. Kjo për shkak se tani e tutje edhe vetë organet e shtetit mund të paraqiten si palë të barabarta në kuadër të rendit objektiv të së drejtës publike. Kjo do të thotë se shteti më nuk është i ndarë nga shoqëria, por pjesë e saj dhe palë e barabartë me tjerët, i cili i nënshtrohet kushtetutës dhe ligjeve. Kjo ka qenë një arritje e madhe, degëzimet e së cilës janë parë në lëmin e përgjegjësisë penale të shteteve dhe në sferën tjetër, kur shteti paraqitet kundrejt individit si një palë e barabartë me te.

Leon Digi, në vëllimin e tretë të veprës së vet madhështore në pesë volume **Traite de droit constituionel** (1921-1929), i ka ndarë garancionet kushtetues në dy lloje: në **garancione preventive** dhe në

garancione sukcesive. Garancionet e para kanë për qëllim shmangien e cenimit të kushtetutës. Dështimi i tyre aktivizon të dytat, të cilat kanë për qëllim pengimin e lëndimit të rendit kushtetues dhe vënien e frerëve ndaj arbitraritetit shtetëror. **Leon Digi** në veçanti thekson dhënien e garancioneve sukcesive një juridiksioni më të lartë me kompetencë të njohur, profesionalizmi dhe paanshmëria e të cilit do të ishin jashtë çdo dyshimi dhe ndaj vendimeve të së cilit të gjithë do të nënshtroheshin, qeveritarët dhe të qeverisurit, përfshirë këtu edhe vetë ligjvënësin. Si shembull për një juridiksion të tillë, ai ka marrë **SHBA**-të, duke luftuar në të njëjtën kohë që edhe në **Francën** e kohës së tij të ketë një shkrirje të kompetencave të **Gjykatës së Kacasionit** dhe **Këshillit të Shtetit**.

Tani i kthehemi debatit të cekur më sipër në mes të Hans Kelsen dhe Karl Shmit, pararendës të të cilit ishin dy autorët e përmendur më lart.

Debati **Kelsen – Shmit** është zhvilluar në gjysmën e dytë të viteve njëzet të shek. XX, në një kohë kur ishin të themeluara gjykatat kushtetuese në Çekosllovaki dhe Austri. Pikëpamjet e H. Kelsen mbi gjyqësinë kushtetuese kishin marrë dhenë në veçanti pas botimit më 1928, për lexuesin jo-gjerman, të punimit të tij **La garantie juridictionnelle de la constitution (La justice constitutionnelle**. Pikëpamjeve të tij i është kundërvënë fuqishëm K. Shmit, në shkrimin e vet **Der Huter Der Verfassun** (1929),[19] i cili po ashtu u pasua nga replika me famë e H. Kelsen **Wer soll der Huter der Verfassung sein**? (1931).[20] Këto punime me tone të theksuara polemizuese janë objekt diskutimi e shtjellimi në këtë seksion.[21] Kjo për faktin se ndikimi i tyre ka qenë vendimtar në formësimin dhe vënien në jetë të gjyqësisë kushtetuese ashtu siç e njohim sot dhe akoma vazhdojnë të diskutohen nëpër katedra e revista shkencore anembanë botës.

Sipas **H. Kelsen**, çështja e garantimit të kushtetutës presupozon ekzistimin e një nocioni të qartë të kushtetutës, i cili buron nga teoria kushtetuese mbi strukturën hierarkike të rendit shtetëror. Në këtë hierarki ekziston një rend bazik, më i lartë se të tjerët, nga i cili buron një tjetër rend tjetër më i ulët. Forma kushtetuese dhe forma legjislative janë në një raport vertikal, ku kjo e dyta i nënshtrohet të parës. Ndryshimi kushtetues bëhet përmes një procedure speciale kurse ndryshimi ligjor përmes një procedure fare të zakonshme. Jo vetëm kaq: kushtetuta përcakton parimet, udhëzimet, si dhe kufijtë e përmbajtjes së ligjit. Kjo nënkupton se kushtetuta nuk është vetëm një formë procedurale, por edhe një rregull materiale (substanciale). Me fjalë tjera, kushtetuta përcakton se një ligj mund të jetë në kundërshtim me te qoftë për shkak të mënyrës së formimit (mënyrës së nxjerrjes) apo për shkak të të metave që lidhen me vetë përmbajtjen. Të metat që lidhen me formën e ligjit, me mënyrën e formimit të tij, zakonisht lidhen me anën e jashtme, si p.sh. cenimet e rregullave gjatë propozimit të ligjit, votimit të tij në parlament dhe kështu me radhë, kurse të metat që lidhen me përmbajtjen e ligjit kanë të bëjnë me mospajtimet e tij me parimet, udhëzimet apo me kufijtë e përcaktuar nga kushtetutëbërësi (sovrani).

Sa i përket garancioneve lidhur me rregullsinë, përkatësisht garancioneve që kanë të bëjnë me mjetet teknike të krijuara me qëllim të garantimit të veprimit fiziologjik të funksioneve shtetërore, si dhe sigurimin e mbrojtjes së kushtetutës, **H. Keslen** thekson qartë se ato duhet t'i lihen në juridiksion një organi tjetër nga ai që i ka nxjerrë ato. Nuk mund të pritet nga parlamenti që t'i nënshtrohet kushtetutës në mënyrë vullnetare. Detyra e anulimit të ligjeve jo kushtetuese nuk duhet t'i takoj ligjvënësit,

---

19 Karl Smit, "Cuvar Ustava". Në Slobodan Samardzic (ed.), *Norma i Odluka. Karl Smit i njegovi kriticari* ("Filip Visnjic": Beograd, 2001) fq. 211-253, në fq. 211-238. Titulli i origjinalit: Carl Schmitt, "Der Huter der Verfasung". A*rchiv des offentlichen rechts*. Neue Folge 16 Band J.C.B. Mohr (Paul Siebeck), Tubingen 1929.

20 Hans Kelsen, "Ko treba da bude cuvar Ustava". Në Slobodan Samardzic (ed.), *Norma i Olduka,* fq. 256-297, në fq. 265. Titulli në original: Hans Kelsen, *Wer soll der Huter der Verfassung sein?* (Dr. Ëalther Rothschild, Berlin-Grunewald, 1931).

21 Për tekstet integrale të punimeve dhe polemikave të dy autorëve si dhe të autorëve tjerë që kanë qenë të përfshirë në debatin mbi kufijtë e të drejtës kushtetuese dhe më gjerë, shih në: Slobodan Samardzic (ed.), *Norma i Odluka. Karl Smit i njegovi kriticari*; Lars Vinx, The Guardian of the Constitution. Hans Kelsen and Carl Schmitt on the Limits of Constitutional Law (Cambridge University Press: Cambridge: 2015).

por një organi tjetër të ndarë dhe të pavarur nga çdo autoritet tjetër shtetëror. Ky organ quhet gjykatë kushtetuese me juridiksion të qartë të kontrollit të legjitimitetit kushtetues të ligjeve.

Për kritikat që kanë të bëjnë me papajtueshmërinë e gjykatës kushtetuese me sovranitetin e parlamentit dhe me ndarjen e pushteteve, **H. Kelsen** paraqet një mbrojtje të dyfishtë. Kushtetuta, thotë ai, në rend të parë normon procedurën e formimit të ligjeve dhe përmbajtjen e tyre, në mënyrë të njëjtë si ligjet që normojnë procedurën e formimit dhe përmbajtjen e gjykatave dhe autoriteteve administrative. Tutje, ligjet i nënshtrohen kushtetutës në po atë mënyrë që gjykatat dhe administrata i nënshtrohen ligjeve dhe, për pasojë, postulati i kushtetutshmërisë së ligjeve, në aspektin teorik dhe teknik, është në tërësi i ngjashëm më postulatin e legjitimitetit ligjor të gjyqësorit dhe administratës.

Në rend të dytë, sipas **H. Kelsen**, në shikim të parë, anulimi i ligjeve nga ana e një organi tjetër nga ai që i ka nxjerrë, paraqet një sulm ndaj pushtetit legjislativ. Por, thotë ai, në esencë kjo nuk është kështu sepse pavarësia dhe forma e organizmit të gjykatës kushtetuese vërtetojnë (tregojnë) se këtu nuk bëhet fjalë për një funksion të vërtetë gjyqësor. Nëse nisemi nga fakti se legjislativi krijon norma të përgjithshme, kurse gjyqësori norma individuale, atëherë, gjithnjë sipas tij, këtu më shumë flitet për një **ligjvënës negativ**, jo për një organ gjyqësor, sepse anulimi i ligjeve ka karakter të përgjithshëm, **erga omnes**, njëjtë siç ka karakter të tillë vetë formimi i tyre. Përveç kësaj, juridiksioni dhe palët e **ligjvënësit negativ**, përkatësisht të gjykatës kushtetuese marrë si tërësi përcaktohen nga teksti i kushtetutës, në ndërkohë që ato të ligjvënësit pozitivë, përkatësisht të parlamentit burojnë nga parimet dhe udhëzimet e përgjithshme kushtetuese lidhur me formën dhe përmbajtjen e ligjeve.

Lidhur me rëndësinë juridike dhe politike të gjyqësisë kushtetuese, **H. Kelsen** potencon faktin se një kushtetutë nuk është e detyrueshme në aspektin teknik nëse nuk ka garancionin e anulimit të ligjeve jokushtetuese. Sa i përket rëndësisë së përgjithshme, e përbashkët për të gjitha kushtetutat, sipas tij, gjyqësia kushtetuese shërben si një mjet për mbrojtjen e pakicës nga abuzimet e shumicës. Esenca e demokracisë nuk është që shumica të bëhet e gjithëpushtetshme, por kompromisi konstant në mes të shumicës dhe pakicës në parlament, përkatësisht paqja dhe harmonia shoqërore. Nga kjo del se gjyqësia kushtetuese shfaqet si një instrument i përshtatshëm për realizimin e kësaj ideje themelore të demokracisë kushtetuese.

Në fund, përveç shtjellimeve të rëndësisë së gjyqësisë kushtetuese në lëmin e raporteve ndërmjet organeve shtetërore, të një rëndësie të madhe janë edhe pikëpamjet e **H. Kelsen** lidhur me rolin e jashtëzakonshëm të gjykatës kushtetuese në marrëdhëniet në mes të subjekteve shtetërore federative. Sipas tij, ideja e federatës realizohet në plotësi vetëm përmes institucionit të gjykatës kushtetuese ngaqë përmes saj ruhet uniteti global i shtetit federal.

K. Shmit, në anën tjetër, në shkrimin e tij të vitit 1931, me titull **Der Huter Der Verfassung,** përpjekjen e **H. Kelsen** dhe bashkëmendimtarëve të tij e sheh si peng të tendencave që kërkojnë zgjidhjen e problemeve shtetërore përmes procedurave të thjeshta gjyqësore, si rruga më e lehtë, duke e fshehur kështu dallimin themelor në mes të vendimit procedural dhe vendimit material (substancial). Ky problem ekziston në çdo vend, çdoherë kur lindin dyshime dhe formohen dallime lidhur me përmbajtjen e një norme kushtetuese.

Duke iu referuar rastit gjerman dhe krahasimit me përvojën amerikane, **K. Shmit** vëren se gjyqësori gjerman nuk mund të jetë gardian i kushtetutës. Në thelb, thekson ai, kontrolli gjyqësor i shndërron gjykatat gardian të kushtetutës përmes vendimmarrjes në formë procesuale. Kjo, sipas **K. Shmit**, mund të ndodhë vetëm në një **shtet gjyqësor**, i cili ia nënshtron tërë jetën publike kontrollit gjyqësor të gjykatave të rregullta. Me këtë shtet, **K. Shmit** nënkupton SHBA-të, praktika e të cilave, gjithnjë sipas tij, duke u bazuar në amendamentet V dhe XIV të Kushtetutës së SHBA-ve, ka për synim kryesor mbrojtjen nga legjislativi të rendit borgjez socio-ekonomik, si rend më i lartë kushtetues. Kjo nuk është kështu me Gjermaninë dhe vendimin famoz të ***Staatsgerichtshof-****it të datës* 4 nëntor 1925. Në rastin gjerman, me vendimin e sipërcekur, ka ndodhur vetëm shmangia nga zbatimi i një ligji të

zakonshëm, pa asnjë efekt lidhur me mbrojtjen apo ruajtjen e **KV** dhe dispozitave të saj. Për të ndodhur në gjë e tillë, pra ruajtja dhe mbrojtja e **KV**, sipas **K. Shmit**, duhet të ekzistojë një lidhje objektive e kuptimit të saj me juridiksionin kushtetues. Për të ekzistuar një juridiksion kushtetues, me një fjalë, sipas **K. Shmit,** duhej të ndryshonte koncepti i **KV** ashtu që ajo të kuptohej si një kontratë në mes të palëve ku paraprakisht do të ishin të paracaktuara, në një mënyrë të qartë, se cilat raste dhe mosmarrëveshje kushtetuese do t'i nënshtroheshin për zgjidhje një gjykate të ndarë - gjykatës kushtetuese.

Staatsgerichtshof**-i, ndërkaq,* ka pasur kompetencë vetëm për zgjidhen e rasteve dhe mosmarrëveshjeve kushtetuese në mes të **lander** (shteteve anëtare të **Republikës së Vajmarit**). I tillë ka qenë edhe vendimi i datës 4 nëntor 1925, me të cilin është vendosur një rast dhe mosmarrëveshje kushtetuese në mes të **lander**-ve gjerman. Shih për këtë **K. Shmit** mohon se mund të ekzistojë një gjykatë e tillë me juridiksion të ndarë kushtetues për krejt Gjermaninë, siç ka ekzistuar ***Staatsgerichtshof**-i*, e cila ka pasur kompetencë vetëm për sa i përket rasteve dhe kontestet kushtetuese në mes të **landër**-ve. Sikur ***Staatsgerichtshof**-i* të kishte pasur kompetenca kushtetuese në nivel **Rajhu**, pra për të zgjidhur mosmarrëveshjet në mes të organeve të shtetit gjerman në nivel qendror, atëherë kjo do të thoshte se **Rajhu** ka një natyrë tjetër juridike që bazohet në një kontratë, në një vullnet plural të shprehur përmes parlamentit gjerman, jo në një vendim unik politik të krejt popullit gjerman. Ky vendim unik konkret i tërë popullit gjerman, sipas **K. Shmit**, paraqet KV: ajo kushtetutë, thënë ndryshe, ka paraqitur vendimin konkret unik të tërë popullit gjerman, jo një kontratë në mes të pjesëve përbërëse të **Rajhut**. Mundësia e ekzistimit të një gjykate qendrore kushtetuese me juridiksion kushtetues për tërë **Rajhun** gjerman, në thelb, sipas **Karl Shmit**, do ta ndryshonte natyrën juridike të **KV**. Në një rast të tillë, ajo do të ishte një kontratë dhe jo vendim politik i krejt popullit gjerman. Çdo kompetencë kushtetuese në nivel qendror e ***Staatsgerichtshof**-it* që ka për objekt çështje kushtetuese në nivel të krejt Gjermanisë, objektivisht, sipas **Karl Shmit**, do ta ndryshonte natyrën juridike të **KV**, duke e kthyer atë në kontratë në mes të shumë grupeve të interesit brenda Rajhut gjerman. Në një rast të tillë, mosmarrëveshjet kushtetuese lidhur me këtë kontratë të re do të zgjidheshin nga nja gjykatë e veçantë kushtetuese me juridiksion të veçantë kushtetues. Me një fjalë, KV nuk ka paraqitur një kompromis, kontratë kompromisi, por një vendim unik politik të krejt popullit gjerman. Ky botëkuptim do të thotë se, për pasojë, krejt problemet lidhur me natyrën e shtetit janë probleme politike të zgjidhshme përmes procesit politik në mes të palëve që veprojnë si organe të Rajhut gjerman, jo përmes mjeteve dhe rrugëve juridiksionale. Një qasje si kjo ka bërë që edhe ***Staatsgerichtshof-i të jetë kompetent vetëm për zgjidhjen e çështjeve kushtetuese në nivel të **lander**, jo në mes të organeve qendrore dhe institucioneve të tjera të larta të **Rajhut**.

Këtë botëkuptim si më sipër për natyrën juridike të **KV**, si një vendim unik politik i krejt popullit gjerman, jo si një kontratë në mes të pjesëve të përbërëse të **Rahjhut**, **K. Shmit** e ka shtrirë edhe ndaj objektit të gjyqësisë kushtetuese dhe institucionit që ushtron këtë lloj të gjyqësisë së specializuar. Si një kritik i ashpër i pluralizmit parlamentar, ai argumentonte se në kohën në mes të dy luftërave parlamenti gjerman ka qenë i përçarë dhe pluralist. Ky fakt, gjithnjë sipas tij, objektivisht e bënte gjyqësorin të paaftë për të qenë një zgjidhje institucionale e problemeve kushtetuese në nivel nacional: problemet e thella socio-politike në shoqërinë gjermane të kohës nuk do të mund të zgjidheshin nga një dhomë e tretë, siç e quante ai gjykatën kushtetuese, e cila sundohet nga **aristokracia e togës**, por vetëm përmes një të treti. Ky i tretë, sipas tij, assesi nuk duhet të kërkohet në gjyqësorin gjerman, por në shefin e shtetit gjerman, si i vetmi me pushtet neutral dhe të pavarur, i cili do të mund t'i zgjidhte problemet e shoqërisë gjermane të kohës.

Nga sa më sipër, shihet qartë se **H. Kelsen** i ka dhënë rëndësi formës institucionale dhe juridiksionale të garantimit dhe mbrojtjes së rendit kushtetues, përkatësisht krijimit të gjykatës kushtetuese ndaras nga gjyqësori i rregullt, me juridiksion të qartë kushtetues të përcaktuar me kushtetutë nacionale. Kundërshtari kryesor i kësaj qasjeje, **K. Shmit**, ka besuar ndërkaq se gardiani i kushtetutës duhej kërkuar në vetë dispozitat e **KV** që flasin për shefin e shtetit gjerman. Kjo për shkak se shefi i shtetit gjerman, jo parlamenti, përfaqësonte vullnetin politik të krejt popullit gjerman, rrethanë që vinte nga fakti se ai zgjidhej nga populli dhe kishte kompetenca ligjvënëse bazuar në nenin 48 të **KV**. Deri te ky pozicion,

K. Shmit kishte ardhur nëpërmjet një interpretimi tepër kritik pozitivist të dispozitave përkatëse të **KV** që, sipas tij, sanksiononin dhe ushqenin një sistem parlamentar jofunksional. Teorinë e tij për gardianin e kushtetutës, pas ardhjes në pushtet më 1933 të **A. Hitler** (**Adolf Hitler: 1889-1945**), **K. Shmit** e bazonte në interpretime të formës konkrete kushtetuese, pra jashtë dispozitave të **KV**.[22] Këtë e ka bërë nga shkaku se, sipas tij, gardiani i kushtetutës përgjithësisht nuk mund të zbulohej nga analiza e normave juridiko-kushtetuese, por vetëm duke u bazuar në vendimin dhe formën konkrete të një vendimi e momenti historik.[23]

Duke kritikuar joefikasitetin e parlamentarizmit gjerman të kohës, **K. Shmit** gjeti në shefin e shtetit të vetmin institucion që mund të garantonte unitetin sociologjik-politik të popullit gjerman. Meqenëse i vetmi ishte presidenti që zgjidhej nga populli, si i tillë vetëm ai personifikonte vullnetin unik dhe homogjen të tërë popullit gjerman. Këtë nuk mund ta bënte, sipas tij, parlamenti plural, i ndarë dhe i copëtuar nga interesat partiake-politike të aktorëve të ndryshëm të shoqërisë vajmariane. Ai shihte **KV** dhe formimin e Gjermanisë vajmariane si rezultat të një vendimi politik, të vetëm dhe unik, të shprehur nga i tërë kombi (populli) gjerman. Vullneti i tillë nuk mund të kishte natyrë pluraliste, përkatësisht nuk mund të realizohej nëpërmjet institucionit të parlamentit, të ndarë dhe të copëzuar nga interesat partiake-politike dhe nga interesat e tjera të aktorëve politikë. Me një parlament të tillë, sipas tij, në shoqëri nuk mbetej askush tjetër përveç presidentit të **Rajhut** që mund të përfaqësonte vendimin unik dhe të vetëm të tërë kombit (popullit) gjerman. Kjo paraqitej kësisoj për arsye se botëkuptimi i **K. Shmit** mbi **KV** ishte se ajo paraqiste një shprehje të një vullneti unik politik dhe konkret të tërë popullit gjerman. Ai vullnet nuk mund të mbrohej përmes formave dhe mekanizmave të natyrës juridiksionale, siç janë gjykata kushtetuese apo ***Staatsgerichtshof***-i si gjykatë më e lartë në vend. *Me fjalë tjera, sipas tij **KV** paraqiste një vullnet konkret dhe unik të krejt popullit gjerman që mund të mbrohej vetëm përmes institucionit të shefit të shtetit, presidentit gjerman, si i vetmi që shpreh vullnetin unik të krejt popullit gjerman për shkak të mënyrës së zgjedhjes së drejtpërdrejt nga populli gjerman, si dhe për arsye të prerogativave kushtetuese nga neni 48 i **KV që i jepnin fuqi*** **ligjvënëse.**

*Thënë shkurt, gardiani i kushtetutës, sipas **K. Shmit** nuk mund të kërkohej as në parlamentin e përçarë gjerman, pluripartiak, e as në një gjykatë të ndarë kushtetuese dhe në **Staatsgerichtshof,** të cilat në asnjë mënyrë nuk mund të shprehnin dhe mbronin vullnetin unik konkret të krejt popullit gjerman për shkak të natyrë së tyre. Kushtetuta nuk është kontratë, por një vendim i vetëm dhe konkret i krejt popullit gjerman dhe, për pasojë, mund të mbrohet vetëm nga ata që shprehin këtë vullnet unik dhe konkret. I vetmi institucion që mund ta bëjë një gjë të tillë është shefi i shtetit gjerman për dy arsyet e cekura më sipër: e para, sepse zgjidhet nga krejt populli gjerman; dhe, e dyta, për shkak se neni 48 i **KV** i njeh atij kompetenca* ligjvënëse.

Pika nisëse e **K. Shmit** në këtë qasje për shefin e shtetit si gardian i vetëm i kushtetutës nuk është e re. Ajo bazohet në teorinë e **Benjamin Konstanit** për të ashtuquajturin **pouvoir neutre et intermediaire**, pushtetin neutral dhe të pavarur. Në shkrimin e tij të cekur të vitit 1931, ai ka kritikuar ashpër teorinë e kohës që modelohej sipas sistemit amerikan, ku gjykatat e larta ishin mekanizmat primarë për mbrojtjen e kushtetutës. Në fakt, gjysma e parë e këtij shkrimi kritik, të gjatë mbi 50 faqe, i dedikohet kritikës

---

[22] **K. Shmit**, me një entuziazëm të pashoq, flet kundër ndarjes së pushteteve, sigurisë juridike, parashikimit të zbatimit të ligjit, si dhe prodhimeve të tjera të liberalizmit pozitivist, siç i quan ai vetë. Në vend të tyre, K. Shmit angazhohet për udhëheqësin (Fyhrerin), si mishërim i tri gjërave në të njëjtën kohë: i shtetit, i kombit dhe i lëvizjes. Shteti, sipas këtij mishërimi, nuk është asgjë tjetër veçse një instrument në duart e udhëheqësit (Fyhrerit). Cf. Karl Smit, *Tri vrste pravnonaucnog misljenja* (Biblioteka *Parerga*: Beograd, 2003) fq. 34-42; 46-54. Titulli në origjinal: Carl Schmitt, *Uber die drei Arten des rechtsëissenschaftlichen Denkens* (Hamburg, Hanseatische Verlagsanstalt, 1934).
K. Shmit, me të drejtë është vërejtur në literaturë, tërë diskursin dhe angazhimin e tij e ka drejtuar kundër "rreziqeve të abstraksionit liberalist, formalizmit legal, *potestats indirecta* dhe shumë shprishjeve të tjera të koncepteve të shkaktuara nga liberalizmi (siç janë, ta zëmë, koncepti i depolitizimit, i largimit të interpretimeve teologjike dhe historike nga politika, etj.)". Cf. William Hooker, *Carl Schmitt's International Thought. Oder and Orientation* (Cambridge University Press: Cambridge, 2009) fq. 126.

[23] Cf. Karl Smit, *Tri vrste pravnonaucnog misljenja,* fq. 16-17.

së sistemit gjyqësor si një mekanizëm për garantimin e kushtetutës.[24] Në pjesën tjetër, ai shpjegon se gardian i kushtetutës mund të jetë vetëm ai organ apo ai institucion që është i furnizuar me kompetenca të veçanta, të cilat ia bëjnë të mundur që të jetë neutral, pra jashtë sistemit të vendosur vajmarian të tri pushteteve të ndara. Këtë pushtet të tretë dhe neutral, ai e sheh te shefi i shtetit, duke u bazuar në teorinë e shekullit XIX të **Benjamin Konstan** dhe në mësimet e tij për **puvoir neuter et intermediare**. Këto autorizime të veçanta dhe neutrale i japin shefit të shtetit mundësinë e ndërmjetësimit në konfliktet e brendshme kushtetuese. Këtu flitet për autorizimet dhe për mundësitë që kanë të bëjnë me pozitën e privilegjuar të shefit të shtetit dhe me pacenueshmërinë e saj, me shpalljen e ligjeve, me të drejtën e faljes, me të drejtën e emërimit të ministrave dhe të zyrtarëve të tjerë shtetëror, si dhe me shpërndarjen e dhomave të zgjedhura të parlamentit. Në **pouvoir neutre et intermendiare** futej edhe rrethana se shefi i shtetit shihej si përfaqësues i kontinuitetit permanent të unitetit shtetëror dhe si garantues i vetëm i funksionimit unik të shtetit. Kjo rrethanë e dytë dilte, në fakt, si pasojë e autorizimeve dhe e privilegjeve presidenciale, të cilat e bënin të mundur kontinuitetin juridiko-shtetëror dhe funksionimin e pandërprerë të institucioneve të sistemit. Këto dualizma, sipas **K. Shmit**, mundësonin që shefi i shtetit të udhëheqë (**regne**) dhe jo të qeverisë (**gouverne**). Kjo e dyta i takonte vetëm qeverisë. Këtu konsiston sintagma e B. Konstan sipas së cilës shefi i shtetit: **il regne et ne gouverne pas**.[25]

H. Kelsen, ndërkaq, në veprën e tij të sipërcekur të vitit 1931, shkrim polemizues i botuar si reagim ndaj shkrimit të mësipërm të **K. Shmit**, sqaron se koncepti i **B. Konstan** për **pouvoir neutre et intermediaire** të shefit të shtetit i referohet monarkisë dhe asnjëherë republikës parlamentare të tipit vajmarian. Sipas **B. Konstanit**, sqaron **H. Kelsen**, monarku ishte pjesë e ekzekutivit. Në fakt, vazhdon më tej **H. Kelsen**, kur **B. Konstan** ka konstatuar se monarku është bartës i një pushteti neutral dhe të ndërmjetëm, atëherë ai këtë e ka mbështetur në faktin se ekzekutivi ndahet në dy pushtete krejt të ndryshme: njëri është pushteti aktiv, kurse tjetri pushteti pasiv. Vetëm ky i dyti i takon monarkut, sepse vetëm ky është pushtet neutral dhe assesi ana e tij aktive.[26] Sipas **H. Kelsen**, ky nuk ka qenë dhe nuk mund të ishte rasti me shefin e shtetit në **Gjermaninë e Vjmarit**, sepse ai ka qenë pjesë aktive e ekzekutivit, si pasojë e kompetencave të mëdha që ka pasur sipas nenit 48 të **KV**.[27] Këto kompetenca, në mënyrë të kulluar, i jepnin atij mundësinë dhe të drejtën për të qeverisur (**gouverner**), pra jo për të udhëhequr (**regener**) në sensin e elaboruar nga **B. Konstan**. Kështu, thotë H. Kelsen, një krahasim i tillë nga K. Shmit është i pavend: sikur shefi i shtetit të caktohej për gardian të kushtetutës, atëherë ai do të shndërrohej në një diktator absolut, marrë parasysh kompetencat e njohura nga neni 48 i Kushtetutës (në veçanti kompetencat për ligjvënie në vend të Rajhstagut).[28] Interpretimin e dispozitës së nenit 48 të **KV** të bërë nga **K. Shmit**, **H. Kelsen** e quajti manipulim, keqkuptim dhe interpretim për qëllime ditore politike, që mëton të quhet shkencë juridike.[29]

---

[24] Karl Smit, "Cuvar Ustava", fq. 211-238; Kritikën e tij për sistemin gjyqësor dhe pamundësinë totale të këtij sistemi për të qenë gardian i kushtetutës, K. Shmit e kishte shtjelluar shumë më herët në librin e tij monumental, me titull "Teoria Kushtetuese". Cf. Carl Schmitt, *Constitutional Theory* (Duke University Press: Durham and London, 2008) fq. 147-164. Titulli i origjinalit: Carl Schmit, *Varfassungslehre* (Duncker und Humblot: Munich and Leipzig, 1928).

[25] Karl Smit, "Cuvar Ustava", fq. 241-253.

[26] Hans Kelsen, "Ko treba da bude cuvar Ustava". Në Slobodan Samardzic (ed.), *Norma i Olduka,* fq. 256-297, në fq. 265.

[27] Vlen të theksohet këtu se, në literaturë, me të drejtë është vërejtur që, në esencë, identiteti i K. Shmitit si konstitucionalist bazohet në avokimin e tij pa rezervë në favor të përdorimit nga Fyhreri të pushteteve (autorizimeve) nga neni 48 i Kushtetutës së Vajmarit. Këtë evokim, K. Shmit e pat filluar qysh me veprën e tij monumentale, "Teoria kushtetuese" ("Verfassungslehre"), (1928). Cf. William Hooker*, Carl Schmitt's International Thought. Order and Orientation,* fq. 129.

[28] Hans Kelsen, "Ko treba da bude cuvar Ustava", fq. 262.

[29] Ibid., fq. 297. Krahasimi i shefit të shtetit të një republike parlamentare moderne me doktrinën e shekullit XIX të **Benjamin Konstanit**, është e pavend. Në shekullin XIX, kjo doktrinë ka pasur për qëllim kufizimin e forcës ekzekutive të monarkut dhe ndarjen e asaj force me përfaqësuesit e popullit (me parlamentin), pra jo me qëllim të ruajtjes së kushtetutës. Doktrina për monarkinë, e cila përmblidhet në shprehjen **il regne et ne gouverne pas**, ka pasur për qëllim kontrollin kushtetues të monarkut, pasivizimin dhe neutralizimin e anës aktive të pushtetit të vjetër ekzekutiv të monarkut absolut të kohës së para **Revolucionit Borgjez Francez** të vitit 1789.

3.3. Periudha pas Luftës së Dytë Botërore: Tri fazat e zhvillimit

Zhvillimi i gjyqësisë kushtetuese pas Luftës së Dytë Botërore ka qenë pjesë e zhvillimeve të përgjithshme socio-politike në botë, në rend të parë në Evropë. E dalë nga katastrofa, Evropa u nda sërish në dysh, në pjesën e vendeve komuniste dhe në vendet jo-komuniste. Këto të dytat u cilësuan si vendet e demokracive kushtetuese perëndimore, për t'u dalluar nga të tjerat që ishin të vetëshpallura si "demokraci popullore komuniste".

Sikur me një profeci, por e cila erdhi pas tragjedisë botërore të viteve 1939-1945, po përmbushej parashikimi i **H. Kelzen** mbi gjyqësinë kushtetuese si një kusht i domosdoshëm i funksionimit të demokracive kushtetuese, si një mekanizëm kontrollues që garanton demokracinë kushtetuese nga sundimi tiranik i shumicës. Kjo, megjithatë, nuk do të thotë se gjyqësia kushtetuese është e pa pajtueshme me sistemet tjera qeverisëse që nuk bazohen në demokraci liberale perëndimore ku dominojnë postulatet e sundimit të ligjit, ndarjes të pushteteve, respektimin e të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve. Këtë e bënë të qartë ekzistenca e gjykatave kushtetuese ne vendet ish-komuniste (Jugosllavia dhe Polonia).

Pas **Luftës së Dytë Botërore**, vendet që dikur kishin qenë fajtore kryesore të tragjedisë së 1939-1945, e gjetën të domosdoshme mbështetjen në mekanizmin e kontrollit gjyqësor si parakusht për tejkalimin e situatës së tyre. Në disa prej tyre u themeluan gjykatat kushtetuese si organe të ndara nga gjyqësori i rregullt, me juridiksion të qartë të përcaktuar me kushtetutë, në të tjerat kjo u bë duke ia besuar këtë rol gjyqësorit të rregullt. **Japonia** ndoqi rrugën e dytë, duke ia besuar detyrën e kontrollit gjyqësor të ligjeve dhe akteve tjera juridike Gjykatës Supreme (**GJSJ**), hap që më vonë u përsërit edhe në vendet tjera në Evropë, si në **Greqi** (1974) ku gjykata e lartë, gjykatat supreme, mori përsipër detyrën e gardianit të kushtetutës nacionale sipas modelit amerikan. Në të tjerat raste u përqafua modeli i përzier apo hibrid, siç ishin disa nga vendet e **Amerikës Latine** deri më 1989, të cilat u diskutuan në seksionet e mësipërme.

Në ndërkohë që përqafimi i gjyqësisë së ndarë kushtetuese në **Austri, Itali,** dhe **Gjermani** shënon fazën e parë në zhvillimin e gjyqësisë kushtetuese, **Greqia** (1974), **Portugalia** (1976) dhe **Spanja** (1978) janë vendet e fazës së dytë ku përqafimi i gjyqësisë kushtetues po ashtu nuk është uniform: **Greqia** përqafoi modelin amerikan, njëjtë siç kishte bërë **Japonia** më herët, **Portugalia** u bë shembull i modelit të përzier apo hibrid, kurse **Spanja** model i llojit evropian/kelsenian, fuqishëm e ndikuar nga **Gjermania**. Vetëm në dy rastet e fundit u formuan gjykatat e ndara kushtetuese, me juridiksion të qartë kushtetues.

Nga rreshtat e sipërm bëhet e qartë se periodizimi i zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese ka për pikë referimi themelimin e gjykatave kushtetuese, si gjykata të kompetencës së veçantë, të ndara nga gjyqësori i rregullt. Ky moment i periodizimit fillon me themelimin e gjykatave të para kushtetuese në Çekosllovaki dhe **Austri** në vitin 1920. Në të njëjtën kohë, kjo konsiderohet si fazë e parë në zhvillimin e gjyqësisë kushtetuese dhe shtrihet deri në vitin 1945, pra deri më mbarim të **Luftës së Dytë Botërore**. Në vendet me gjyqësi të ndarë kushtetuese të fazës së parë hyjnë edhe **Kuba** (1940), kurse dhe **Egjipti** (1941) paraqet vendin e parë në vendet arabe që nisi praktikën e kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë së ligjeve, por jo sipas modelit evropian/kelsenian.

Në kuptimin e sqaruar si më sipër, pas vitit 1945 ekzistojnë tri faza të tjera të zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese. Faza e parë fillon me rikrijimin e Gjykatës Kushtetuese të Austrisë (**GJKA**) në vitin 1945, krijimin e gjykatave kushtetuese në **Itali** (GJKIt) e **Gjermani** (GJKGJe) respektivisht në vitet 1948 dhe 1949. Në këtë fazë të zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese përfshihen edhe vendet si **Franca** (KKFr: 1958), **Qipro** (GJKQi: 1960), **Turqia** (GJKT: 1962) dhe ish **Jugosllavia** (GJKJu: 1963). Në dy rastet e fundit kemi të bëjmë me një kontekst tjetër kulturor (**Turqia**) dhe ideologjik (ish-**Jugosllavia**) nga ai i vendeve të Evropës perëndimore në të cilat më parë ishin themeluar gjykatat kushtetuese. Kjo, megjithatë, vetëm sa vërteton konstatimin si më sipër se gjyqësia kushtetuese nuk është prerogativë dhe monopol i kulturave apo ideologjive të caktuara. Si e tillë, gjyqësia kushtetuese, e cilësdo formë qoftë, mund të ushtrohet edhe në vendet me stof kulturor jo-liberal të proveniencës tjetër nga ajo perëndimore (vendet si **Turqia** dhe vendet tjera arabe dhe

myslimane pas mbarimit të komunizmit), si dhe në vendet me ideologji jo-liberale të proveniencës tjetër nga ajo perëndimore (ish-**Jugosllavia**).

Konteksti ideologjik komunist nuk ka qenë fare i paraparë nga **H. Kelsen** si një rrethanë që lejon mundësinë e krijimit të gjyqësisë kushtetuese. Krejt në të kundërtën, siç u pa nga debati **Kelsen – Shmit**, ka qenë konteksti i zhvillimit të demokracisë kushtetuese, i cili konsiston në sundim të ligjit, ndarje të pushtetit, respekt të të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve, ai që ka qenë në mendjen dhe shpirtin e **H. Kelsen** kur ka projektuar konceptin e gjyqësisë kushtetuese dhe vendin e saj në sistemin nacional të drejtësisë. Në fakt, gjyqësia kushtetuese siç është paramenduar nga ai, krahasuar me sistemin e gjyqësisë kushtetuese ish- jugosllave, paraqet një paradoks në vetvete: në rastin e fundit, **GJKJu** ka pasur për detyrë të ruajë unitetin e pushtetit komunist, jo ndarjen e tij, i cili bazohej në diktaturën e proletariatit dhe në avangardizmin e partisë komuniste si truri i asaj diktature. E njëjta vlen edhe për gjykatat kushtetuese të ish-republikave jugosllave dhe gjykatat kushtetuese të **Vojvodinës** e **Kosovës**. Sistemin jugosllav të gjyqësisë kushtetuese e diskutojmë në kapitullin që flet për gjyqësinë kushtetuese të vendeve ish-komuniste.

Sa i përket kontekstit kulturor, vlen të theksohet gjithashtu se ai nuk ka qenë fare objekt trajtimi në veprën e **H. Kelsen**. Konteksti kulturor në diskursin **kelsenian** nuk përbën një kusht të domosdoshëm që mundëson formimin e gjykatës së ndarë kushtetuese, një gjykatë që ka për detyrë primare ruajtjen e postulateve të demokracisë kushtetuese të proveniencës liberale perëndimore, përkatësisht ruajtjen e sundimit të ligjit, ndarjes së pushtetit, respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve. Në këtë drejtim, **Turqia** dhe gjyqësia e saj kushtetuese bëjnë pjesë në vendet e demokracive kushtetuese perëndimore, të cilat e kanë gjykatën kushtetuese si të ndarë nga gjyqësori i rregullt dhe me juridiksion të veçantë për çështjet kushtetuese, mirëpo stofi i saj kulturor është i ndryshëm nga ai i vendeve të origjinës së gjyqësisë kushtetuese.

Faza e dytë pas vitit 1945 fillon me rënien e diktaturave në Gadishullin Iberik, në **Portugali** dhe **Spanjë**. Edhe në lindjen e kësaj faze dhe të dy gjykatave kushtetuese të këtyre dy vendeve iberike, qartë vërtetohet teza se gjyqësia kushtetuese, dhe mbrojtja gjyqësore e kushtetutës, kanë lindur[30] dhe lindin[31] si një nevojë e domosdoshme gjatë kohës së krizave të thella politike dhe ndërprerjeve radikale me të kaluarën, pas revolucioneve dhe përmbytjeve të tjera të thella sociale e politike, jo duke u bazuar në stofin e caktuar kulturor apo ideologjik.

Portugalia dhe tribunali i saj kushtetues (**TKPo**), i themeluar më 1982, nuk mund të kuptohen nëse nuk njihet historia krejt specifike e këtij vendi. Në fillim, në **Kushtetutën e Republikës së Portugalisë** (1911) ka dominuar ndikimi amerikan. Ky ndikim ka vazhduar edhe në Kushtetutën e vitit 1933. Në këtë periudhë ka ekzistuar një kontroll gjyqësor, i shpërndarë (difuz /i decentralizuar), incidental dhe konkret, njëjtë si në **SHBA**. Para kohës republikane, para vitit 1911, ka qenë mjaft prezent ndikimi francez, përkatësisht kontrolli kushtetues politik sipas modelit të **Francës** post-revolucionare: brenda organit përfaqësues krijohen trupa të brendshme që ushtrojnë kontroll politik të kushtetutshmërisë së ligjeve.

Modeli i kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë, i instaluar më 1911 dhe i vërtetuar më 1933, megjithatë, nuk arriti të pengojë futjen e vendit nën sundimin autoritar të diktatorit **Salazar** (**Antonio de Oliveira Salazar: 1889-1970**) para Luftës së Dytë Botërore. Ky sundim ka zgjatur deri vonë në fillim të viteve '70 të shekullit të kaluar. Pas këtyre ndryshimeve, më 1976 u nxor **Kushtetuta e Portugalisë**, e cila parashikonte formimin e një komisioni kushtetues kalimtar, deri në formimin e gjykatës kushtetuese, e cila

---

30 Në shkrimin e tij polemizues të sipërpërmendur, **Der Huter Der Verfassun**g, Karl Shmit gjen se në historinë moderne kushtetuese mbrojtja e rendit kushtetues përmes krijimit të një trupi të veçantë kushtetues ka nisur me vdekjen e **Oliver Kromvellit** (**Oliver Cromwell: 1599-1658**) dhe frikën e restaurimit të monarkisë. Karl Smit, "Cuvar Ustava". Në Slobodan Samardzic (ed.), *Norma i Odluka.* fq. 211.

31 Michele Belletti,:Il sistema di giustizia costituzionale portoghese". Në Luca Mezzeti (ed.), *SISTEMI E MODELLI DI GIUSTIZIA COSTITUZIONALE*, fq. 268.

aktualisht ekziston në këtë vend. Komisioni kishte prerogativë të kontrollit kushtetues politiko-ushtarak të ligjeve. Kjo praktikë u ndërpre më 1982, kur u themelua **TKPo**, me kompetenca ekskluzive juridiksionale të kontrollit kushtetues të koncentruar dhe të shpërndarë. Sikundër shihet, ky vend ka përqafuar **modelin e përzier** apo **hibrid** të gjyqësisë kushtetuese. Për sistemin portugez të gjyqësisë kushtetuese do të flasim më shumë në kapitullin në vijim.

Historia e **Spanjës** me gjyqësinë kushtetuese nuk është shumë e ndryshme nga ajo e Portugalisë. Në Spanjë, përherë ka nisur gjyqësia kushtetuese me Kushtetutën e vitit 1931, e cila parashikonte themelimin e **Tribunalit të Garnacioneve Kushtetuese (TGKS)**. Ky organ nuk pati jetë të gjatë për shkak të futjes më 1939 të diktaturës fashiste të gjeneralit **Franko** (**Francisco Franco: 1892-1975**). Pas pesëdhjetë vjet të diktaturës, më 1976 Spanja vendosi të rithemelojë tribunalin e vet kushtetues **(TKSp)**, i cila, përveç kontrollit të centralizuar të kushtetutshmërisë së ligjeve, ka edhe prerogativa të gjëra në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kushtetuese. Kjo thuhet qartë në nenet 159-165 të kapitullit IX të Kushtetutës (1976), të cilat flasin për **TKSp**. Edhe në Spanjë, njëjtë si në Portugali, qëllimi i formimit të gjyqësisë kushtetuese, të ndarë nga gjyqësori i rregullt, ka qenë që të sigurojë rendin e ri kushtetues demokratik, i cili bazohet në ndarjen e pushteteve, sundimin e ligjit si dhe në respektin për drejtat e njeriut dhe të minoriteteve.

Lindja e gjyqësisë kushtetuese në vendet e **Amerikës Latine** pas vitit 1945 ka qenë pjesë e valës së përhapjes së tyre në Evropë dhe gjetiu dhe përbën një tregim të veçantë, tregim që nuk mund të kornizohet në kuadrin e fazave të zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese evropiane.

Tregimi për gjyqësinë kushtetuese nëpër këto vende është i ndarë nga periodizimet evropiane si më sipër dhe atë për arsye: *e para*, vendet e Amerikës Latine kanë ruajtur trashëgiminë e pasur të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe të akteve tjera juridike, trashëgimi e krijuar përgjatë shekujve XIX dhe XX; *e dyta*, krahas kësaj tradite të pasur dhe të vjetër të ndikuar kryesisht nga SHBA, e cila vazhdon të jetë aktualisht traditë me ndikim në Amerikën Latine, modeli hibrid apo i përzier i kontrollit kushtetues nëpër këto vende ka një shtrirje dukshëm më të gjerë. Këtu kemi parasysh në veçanti **Ekvadorin**, **Guatemalën**, **Kilin**, **Kolumbinë** dhe **Perunë**, të cilat vende do të trajtohen në vijim. Nga vendet e Amerikës Latine, ndërkaq, krahas **Guatemalës**, vetëm **Bolivia**, **Kolumbia** dhe **Peru** kanë gjykata të ndara kushtetuese me juridiksion të veçantë dhe të ndarë nga gjyqësori i rregullt**.**

Bazuar në modelin spanjoll të Kushtetutës së vitit 1931, **Ekuadori** më 1945 themeloi **Tribunalin e Garancioneve Kushtetuese** (**TGKE**). Ky organ, megjithatë, nuk ishte i tipit të gjyqësisë kushtetuese pasi që nuk kishte të drejtën e kontrollit kushtetues të legjitimitetit të ligjeve. Kontrolli që kishte të drejtë të ushtronte **TGKE** ka qenë i tipit politik dhe ankorohej në organin legjislativ. Pas kësaj, ai kishte të drejtën e suspendimit të përkohshëm të ligjeve të vlerësuara si kundërkushtetuese. Kjo e metë e Kushtetutës së vitit 1945, e përsëritur një vit më vonë me kushtetutën e re të atij viti, u përmirësua me Kushtetutën e vitit 1978, e cila tani njohu një tribunal kushtetues autonom me kompetencë gjyqësore kushtetuese të veçantë.

Kushtetuta e Guatemalës (1879), e amendamentuar më 1921, ka qenë e para që ka futur modelin e gjyqësisë kushtetuese në kuadër të Gjykatës Supreme të këtij vendi. Sistemi guatemalez i gjyqësisë kushtetuese merr një karakter të përzier vetëm me Kushtetutën e vitit 1965. Në këtë vit është themeluar **Corte de Constitucionalidad** apo **Gjykata e Kushtetutshmërisë (GJKG)**, e cila ka funksionuar si një trup **ad hoc** në kuadër të Gjykatës Supreme. Më 1982, puna e saj qe suspenduar si pasojë e puçit ushtarak në këtë vend. Guatemala mund të konsiderohet si vendi i parë në Amerikën Latine që ka krijuar një gjykatë kushtetuese autonome dhe jashtë sistemit të gjyqësorit të rregullt, nisur nga fakti se **TGKS** i themeluar në **Kubë** më 1940, ka funksionuar në kuadër të Gjykatës Supreme kurse në **Ekuador**, **TGKE** i vitit 1945 nuk ka qenë një organ i gjyqësisë kushtetuese me kompetenca të kontrollit kushtetues të centralizuar. E kemi fjalën për Kushtetutën e vitit 1985, e cila i dha **Guatemalës** gjyqësi të ndarë kushtetuese, me emërtimin që kishte pasur në vitin 1965, pra si **GJKG**. Kjo Kushtetutë është amendamentuar në vitin 1993. Me këto amendamente, në kompetencë të **GJKG**, si një gjykatë kushtetuese e plotë e këtij vendi, u lanë jo vetëm kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjeve, akteve juridike dhe akteve tjera të autoriteteve

publike por edhe çdo çështje tjetër kushtetuese që ka të bëjë më të drejtat dhe liritë e kushtetuese. Mjeti juridik për mbrojtjen e këtyre të fundit ankorohet në institutin e njohur si **amparo**, mjet i cili mund të ushtrohet qoftë si mjet i vetëm juridik, i ndarë nga rasti (civil, penal apo administrativ), apo edhe gjatë zhvillimit të një procedure gjyqësore lidhur me të drejtat dhe liritë kushtetuese.

Me Kushtetutën e Kilit (1925) për herë të parë u njoh kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve tjera juridike përmes rrugëve juridiksionale. Kjo e drejtë iu njoh **Gjykatës Supreme të Drejtësisë** (**GJSDK**), si një e drejtë ekskluzive me karakter të juridiksionit origjinal dhe të drejtpërdrejtë. Kjo procedurë e kontrollit kushtetues vihej në lëvizje përmes të a.q. **kërkesës për moszbatim**. Përmes kësaj kërkese mund të zgjidhej çështja e legjitimitetit kushtetues të ligjeve dhe akteve tjera në cilëndo fazë që vihej në pyetje legjitimiteti kushtetues i tyre. Kjo kërkesë nuk shkaktonte pezullimin e procedurës së rregullt gjyqësore në të cilën vendosej rasti apo mosmarrëveshja konkrete në mes të palëve. Efekti i vendimit lidhur me legjitimitetin kushtetues të ligjeve dhe akteve tjera juridike, megjithatë, nuk ishte i përgjithshëm, **erga omnes**, por vetëm në mes të palëve, **inter partes**, duke pasur vlefshmëri vetëm për procedurën ku pritej vendosja e rastit dhe mosmarrëveshjes, përkatësisht në procedurën në të cilën ishte ngritur **kërkesa për moszbatim**.

Me ndryshimet kushtetuese të vitit 1970, u themelua **Tribunali Kushtetues** (**TKK**), i veshur me kompetenca vendimmarrëse në rastet e a.q. **plan de veto**, një institut që ishte njohur në **Kushtetutën e Kolumbisë të vitit 1886** dhe në **Kushtetutën e Ekuadorit të vitit 1869**. Me **plan de veto** mund të kërkohej vënia në lëvizje e kompetencës për kontroll preventiv të kushtetutshmërisë së ligjeve. **TKK** pat një jetë të shkurtër: në shtator të vitit 1978 e suprimoi diktatori kilean, gjenerali **Augusto Pinocet** (**Augsto Pinochet: 1915 - 2006**). Në vend të tij, Gjykata Supreme u kujdes për ruajtjen e supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës, ani se ajo ishte suspenduar (pezulluar) dhe ekzistonte vetëm në letër.

Tribunali i Garancioneve Kushtetuese (TGKP), i themeluar me **Kushtetutën e Perusë të vitit 1979**, njëjtë si organet tjera të gjyqësisë kushtetuese si më sipër, i përket tipit të përzier të gjyqësisë kushtetuese. Kjo është kështu për dy arsye. e para, gjyqësia kushtetuese në **Peru** fokusohet, si në rastet cekura më sipër të tipeve të përziera, në një organ të veçantë dhe të ndarë e autonom, **TGKP**, i cili ushtron kontroll të centralizuar të legjitimitetit kushtetues të ligjeve dhe të akteve tjera juridike; dhe, e dyta, **TGKP** ushtron një kontroll kushtetues ndaj veprimeve të gjyqësorit të rregullt, i cili në tërësi është i detyruar t'i zbatoj precedentët e mëhershme të tij.

Me ndryshimet kushtetuese të vitit 1968, **Kolumbia** krijoi një seksion (dhomë) kushtetuese në kuadër të **Gjykatës Supreme të Drejtësisë (GJSDK)**. Ky seksion (dhomë) kishte për detyrë të jepte mendime lidhur me çështjet e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve tjera juridike në vijim të zgjidhjes dhe vendosjes për rastet konkrete në kuadër të **GJSDK** apo në vijim të zgjidhjes dhe vendosjes së rasteve të filluara përmes **actio popularis**. Vetëm më vonë, me Kushtetutën e vitit 1991 u krijua një gjykatë autonome kolumbiane me juridiksion të veçantë kushtetues.

Vendet **arabe** dhe vendet tjera **islamike** në periudhën deri në rrëzimin e komunizmit kanë pasur një zhvillim të qetë dhe të ndarë nga të tjerët, jo vetëm në aspektin socio-politik dhe historik, por, mbi të gjitha, në aspektin që diskutohet në këtë libër, pra në aspektin e zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese dhe zbatimit të kontrollit kushtetues të ligjeve. Të shohim si duket ky zhvillim në botën arabe dhe islamike në këtë fazë të zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese.

Kushtetuta e Sirisë (1920) parashikonte formimin e Gjykatës Supreme, por jo me autorizime për të bërë kontrollin kushtetues të veprimit ekzekutiv apo legjislativë të autoriteteve publike. Për shkak të statusit të saj të varur nga **Franca**, gjyqësori sirian në këtë fazë nuk mund ta zhvillonte jashtë kuadrit kushtetues, sipas modelit amerikan, një kontroll autonom kushtetues. Vetëm tri dekada më vonë kjo do të jetë e mundur dhe pas kësaj kohe çdo kushtetutë siriane do ta parashikojë një mundësi të tillë, pra mundësinë e veprimit autonom të kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë.

Kushtetuta e Irakut (1925), si kushtetutë e parë e një vendi të pavarur, parashikonte mundësinë e kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë së veprimit legjislativ dhe ekzekutiv. Këtë rol e luante Gjykata e Lartë e Irakut. Në fakt, **Iraku** është vendi i parë arab që parashikoi me kushtetutë në mënyrë shprehimore institutin e kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë.

Në **Egjipt**, vendimi i vitit 1941, i cili u rrëzua nga apeli, u riaktualizua në vitin 1958. Në këtë vit, Gjykata Supreme Administrative e Egjiptit (**GJSAE**), përfundimisht vuri themelet e gjyqësisë kushtetuese në këtë vend, jashtë tekstit kushtetues, pra sipas modelit amerikan.

Kjo ishte krejt ndryshe me rastin jordanez: **Kushtetuta e Jordanisë** (1952) i jepte mundësinë Gjykatës së Lartë që të deklarohej me fuqi detyruese për kushtetutshmërinë e ligjeve, kur një gjë e tillë kërkohej nga Parlamenti apo Qeveria.

Kushtetuta e Kuvajtit (1962) ka qenë e para në vendet arabe që ka parashikuar mundësinë e themelimit të një gjykate të ndarë kushtetuese, me juridiksion të qartë dhe të specializuar kushtetues. Kjo u realizua në praktikë, megjithatë, shumë më vonë, njëmbëdhjetë vjet më pastaj, me Ligjin Nr. 14 të vitit 1973. Në këtë kohë prej njëmbëdhjetë vjetësh, gjykatat kuvajtiane nuk u imponuan për të futur në skenë institutin e kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë.

Në ndërkohë, edhe disa vende të tjera arabe themeluan gjykatat e tyre kushtetuese. Kështu, **Kushtetuta e Marokut** (1962) parashikonte themelimin e një dhome të specializuar kushtetuese, kurse juridiksioni i ngjashëm që ushtrohej nga **Gjykata Supreme e Egjiptit** që nga viti 1969, me Kushtetutën e vitit 1971 u transformua në **Gjykatën Supreme Kushtetuese (GJSKE)**. Thuhet se ndikimi i **Egjiptit** ka qenë vendimtar për krijimin e gjykatave të ndara kushtetuese në **Jemen** (1970), **Sudan** dhe **Siri** (1973). **Emiratet e Bashkuara Arabe,** me themelimin e tyre në vitin 1971, parashikuan formimin e një gjykate supreme, por që nuk kishte autorizime të natyrës së kontrollit kushtetues.

Asnjëri nga këto organe si më sipër nuk janë parë në fillim si mbrojtës të konstitucionalizmit nëpër këto vende. Fundi i viteve ’70 të shekullit të kaluar ka qenë fillim i një liberalizmi ndër vendet arabe, gjë që ka ofruar mundësi për një përdorim më ofensiv dhe kurajoz të kontrollit kushtetues, si dhe për forcim të organeve të ngarkuara me ushtrimin e kontrollit kushtetues.[32]

Kështu, në **Egjipt** më 1979 u nxor legjislacioni implementues për vënien në jetë të reformës kushtetuese të vitit 1971, duke e transformuar Gjykatën Supreme në një gjykatë autonome, në **GJSKE**.

Më 1987, një gjykatë e ulët në **Tunizi** imponoi institutin e kontrollit kushtetues sipas modelit amerikan, pra jashtë tekstit kushtetues të këtij vendi, në ndërkohë që presidenti i vendit po këtë vit dekretoi një këshill kushtetues sipas modelit francez, por i cili kishte vetëm rol konsultativ.

Algjeria (1989) dhe **Libani** (1990), siç mund të pritej, themeluan këshillat kushtetues sipas modelit francez. Më vonë, më 1991, **Jordania** shprehu dëshirën për themelim të një gjykate të ndarë kushtetuese, gjë që ngeli në letër vetëm si një dëshirë e këtij vendi. Mirëpo, më 1998 **Gjykata e Lartë e Jordanisë** u imponua si organ që kishte të drejtën e kontrollit kushtetues të legjislacionit, jo vetëm kur kërkohej nga pushteti por edhe gjatë një procesi normal gjyqësor. Kjo u pa në rastin e një ligji për shtypin, të cilin kjo gjykatë e gjeti si jo kushtetues, duke theksuar se kufizimi i lirisë së shtypit mund të bëhej vetëm në situatat e gjendjes së jashtëzakonshme.

Duhet theksuar se gjyqësia kushtetuese dhe kontrolli gjyqësor në vendet **arabe** dhe në vendet **myslimane** në përgjithësi kanë pasur një rol minimal si pasojë e strukturave jodemokratike të qeverisjes në këto vende. Rasti i këtyre vendeve dhe i vendeve të tjera jodemokratike, qartë tregojnë se supremacia (epërsia) e kushtetutës dhe e rendit objektiv të bazuar në te kanë kuptim vetëm atëherë kur segmentet tjera të pushtetit dhe raporti i tij ndaj individit kuptohen në frymën e demokracive liberale kushtetuese.

---

32 Nathan J. Brown, *Constitutions in a Nonconstitutional World*, fq. 149.

Në këto demokraci, vlerat tjera, siç janë sundimi i ligjit, ndarja e pushtetit, si dhe respekti për të drejtat të njeriut dhe të minoriteteve janë thellë të rrënjosura në kulturën kushtetuese nacionale. Për pasojë, edhe sigurimi i supremacisë (epërsisë) së kushtetutës ka efektin e vënies në jetë të këtyre postulateve të rrënjosura në kulturën kushtetuese nacionale. Ky nuk është rasti me vendet arabe dhe vendet tjera jodemokratike, ku sigurimi i supremacisë (epërsisë) së kushtetutës ka për qëllim përjetësimin dhe përligjësimin e strukturave jodemokratike të qeverisjes të përcaktuara më kushtetutë, ku janë të huaja postulatet e ndarjes së pushteteve, sundimit të ligjit, respektit për të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve.

3.4. Rënia e komunizmit dhe zhvillimet në gjyqësinë kushtetuese

Faza e tretë e zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese, pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, fillon me rrënimin e **Murit të Berlinit** më 1989, vit që shënon rënien e komunizmit dhe ribashkimin e Evropës. Me këtë nis përhapja e shpejt dhe marramendëse e gjyqësisë kushtetuese e modelit **evropian/kelsenian**, pra lindja dhe përhapja e gjykatave kushtetuese të kompetencës së veçantë në lëmin kushtetues, të ndara nga gjyqësori i rregullt.

Në këtë seksion vetëm i përmendim kontinentet ku janë krijuar gjykatat e reja kushtetuese të modelit kelsenian sepse diskutimi për shumicën prej tyre vazhdon kur të flasim për gjeografinë e përhapjes së gjyqësisë kushtetuese. Kjo bëhet edhe për arsye se këto gjykata kushtetuese, pak a shumë kanë një fizionomi të njëjtë dhe funksione të ngjashme si pasojë e hibridizimit të tyre gjatë procesit të lindjes, proces i ngjizur si rrjedhojë e migrimit të ideve kushtetuese në kohën e globalizmit të hovshëm pas vitit 1989. Kjo ngjizje është vërejtur edhe në sferën e përdorimit intensiv të **precedentëve të jashtëm** kushtetuese nga ana e gjykatave të reja të valës së tretë, dukuri kjo mjaft e përhapur deri në ditët e sotme. Për më tepër, në disa raste, vetë kushtetutat e reja nacionale kanë sanksionuar një qasje të tillë ndaj burimeve të huaja të së drejtës kushtetuese, duke e kthyer përdorimin e tyre në praktikë gati në një detyrim kushtetues. **Kosova** bën pjesë në këtë grup të vendeve, në veçanti kur bëhet fjalë për precedentët në sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut. Kjo për shkak se, siç do të flasim në vijim të kapitujve relevantë të këtij libri, neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] i Kushtetutës shprehimisht thotë se **"të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".** Në fakt, liritë dhe të drejtat e njeriut përbëjnë sferën në të cilën një pjesë bukur e madhe e vendeve ish-komuniste dhe vendeve të tjera të valës së tretë të gjyqësisë kushtetuese shprehin dashamirësi të madhe, dhe tolerancë deri në detyrim kushtetues sa i përket përdorimit të **precedentëve të huaj**.

Aktualisht, në mënyrë apodiktike mund të konkludohet se në asnjë pjesë të botës, kontrolli kushtetues nuk paraqet më një përjashtim, siç ka qenë në të kaluarën, por një rregull. Këtu nuk e kemi fjalën vetëm për modelin **evropian/kelsenian** të gjyqësisë kushtetuese, por për të gjitha format e kontrollit kushtetues. Modeli në fjalë, duhet vënë në dukje këtu, është më i përhapur në vendet e **Evropës**: në vendet ish-komuniste, pas rënies së murit të **Berlinit** më 1989 dhe rrënimit të komunizmit, gjykatat kushtetuese u krijuan në këto vende: **Shqipëria** (1989), **Hungaria** (1989), **Bullgaria** (1991), **Rumania** (1991), **Polonia** (1992), **Republika Cekisë** (1992), **Sllovakia** (1992), **Lituania** (1992), **Rusia** (1993), **Bellorusia** (1994), **Moladavia** (1995), **Ukraina** (1996), **Gjeorgjia** (1996).

Vendet si më sipër përqafuan me të madhe sistemin kelsenian të kontrollit kushtetues, ani se risitë institucionale nuk kanë munguar. Janë tri arsye për pranim të këtij sistemi në vendet ish komuniste, pra të një sistemi të centralizuar të kontrollit kushtetues ku juridiksioni bartet në një organ të vetëm dhe të ndarë nga gjyqësori i rregullt:

a) E para, sepse bëhet fjalë për vende që i takojnë familjes juridike të së drejtës civile (romake);

b) E dyta, sepse ka ekzistuar një dëshirë e flaktë e këtyre vendeve për t'u anëtarësuar, fillimisht në Këshill të Evropës e më pastaj në Bashkimin Evropian; dhe

c) E treta, sepse këto vende kanë kaluar nëpër një periudhë autoritarizmi, rrethanë që ka krijuar një ambient të përshtatshëm për pranim të sistemit të centralizuar të gjyqësisë kushtetuese më parë se të një sistemi të decentralizuar.

Këto vende, megjithatë, nuk kanë mundur t'i ikin disa aspekteve të sistemit të decentralizuar, gjë që shihet në përqafimin e gjerë të **kontrollit incidental** të kushtetutshmërisë. Kjo rrethanë ka bërë që në literaturë sistemi i ish-vendeve komuniste të **Evropës** të cilësohet si një sistem hibrid apo i përzier, tërësisht unik krahasuar me tjerët, sepse, në disa raste, ka ngërthyer në vete edhe elemente të tjera nga e kaluara, siç është kontrolli i ligjshmërisë si një juridiksion që nuk ka qenë i njohur gjetiu në gjyqësinë kushtetuese të modelit kelsenian. Përveç kësaj cilësie të gjyqësisë së vendeve ish-komuniste, ekziston edhe një tjetër, e që lidhet me kufizimin e efekteve juridike të gjyqësisë kushtetuese, e cila është futur në disa prej këtyre vendeve.

Përkundër risive institucionale të vendeve ish-komuniste, esenca ngelet e njëjtë si në vendet e gjyqësisë kushtetuese tradicionale evropiane të proveniencës kelseniane: krijimi i një organi të ndarë me juridiksion të qartë kushtetues, i ndarë nga gjyqësori i rregullt, me monopol ekskluziv sa i përket kontrollit të kushtetutshmërisë (dhe të ligjshmërisë në disa vende)[33].

Në vijim jepet në mënyrë telegrafike pasqyra e formimit të gjykatave kushtetuese dhe të gjykatave të tjera me kompetencë për kontroll të kushtetutshmërisë, që kanë lindur në fazën e tretë të zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese. Në kapitujt tjerë respektivë diskutohet në detaje ndonjëra prej këtyre gjykatave, së bashku me historinë e formimit dhe llojin e juridiksionit të tyre.

Në Amerikën Latine, u themeluan gjykatat e ndara kushtetuese në këto vende: **Kolumbia** (1991), **Bolivia** (1994), **Ekuadori** (1998).

Në Afrikë, gjykatat kushtetuese themelohen në këto vende pas rënies së komunizmit: **Benin** (1990), **Burundi** (1991). **Gabon** (1991) **Mali** (1991) **Togo** (1992), **Madagaskar** (1992), **Afrika e Jugut (1997).**

Nga **vendet arabe**, gjykatë kushtetuese në këtë fazë themeloi vetëm **Tunizia** (2014).

Këshillat kushtetuese, sipas modelit francez, u themeluan në disa vende në Afrikë dhe në vendet tjera arabe: **Algjeria** (1989) dhe **Libani** (1990), të cilat u cekën më herët, **Mauritania** (1991), **Kongo** (1992), **Xhibuti** (1992), **Bregu i Fildishtë** (1994), **Maroko** (1992), **Senegali** (1992). Sikundër shihet, në këto vende është riprodhuar koncepti dhe praktika e këshillit kushtetues, sipas shembullit francez. Kjo ka ardhur si pasojë e faktit se disa nga këto vende kanë qenë për një kohë të gjatë ish koloni franceze ku ekziston një ndikim i fortë kulturor francez si një ish metropole e këtyre vendeve.[34]

Në **Azi**, gjykata kushtetuese të themeluara në **Republikën e Koresë** (1989), **Tajlandë** (1997), **Indonezi** (2001), dhe **Mongoli** (1992). Këto luajtën një rol të rëndësishëm në frenimin e pushtetit politik gjatë kohës së tranzicionit demokratik por edhe më vonë gjatë kohë së konsolidimit të demokracisë kushtetuese në këto vende e deri më sot.[35] Përveç kësaj, suksesi i këtyre gjykatave kushtetuese dhe i gjyqësisë së

---

[33] Carna Pistan, "La giustizia costituzionale nell' Europa centro-orientale: le esperienze di Croazia, Slovenia, Polonia, Ungheria." Në Luca Mezzeti (ed.) *SISTEMI E MODELI DI GIUSTIZIA COSTITUZIONLAE*, fq. 393-398.

[34] Babacar Kante "Models of Constitutional Jurisdiction in Francophone Africa". Në Andrew Harding and Peter Leyland (eds.), Constitutional Courts. A Comparative Study (Wildy, Simmonds & Hill Publishin: London, 2009) fq. 263-288; Për aspektet e ndikimit kolonial në zhvillimet e demokracisë në përgjithësi në vendet ish koloniale, cf. më shumë në Benjamin Isakhan and Stephen STockwell (eds.), *The Edinburgh Companion to the History of Democracy. From Pre-History to Future Possibilities* (Edinburgh University Press: Edinburgh, 2015), Chapter V: Colonialsim and Democracy", fq. 223-267. Në këtë kapitull jepen studimet individuale të tre autorëve që flasin gjerësisht për ndikimet e fuqishme kulturore në vendet ish koloniale të metropolave të vjetra.

[35] Tom Ginsburg, "Constitutional Courts in East Asia: Understanding Variation." Në Andrew Harding and Peter Leyland (eds.), *Constitutional Courts. A Comparative Study* (Wildy, Simmonds & Hill Publishin: London, 2009) fq. 291-316; Andrew Harding and Peter Leyland, "The Constitutional Courts of Thailand and Indonesia: Two case Studeis from South East Asia ". Në Andrew Harding and Peter Leyland (eds.), *Constitutional Courts. A Comparative Study*, fq. 317-341.

kultivuar nga to qëndron edhe në faktin se në shumicën e këtyre vendeve ka pasur një ndikim shumë të madh tradita fetare budiste dhe konfuqianiste, krahas fesë islame. Këtu, në këtë libër, ne flasim vetëm për gjyqësinë kushtetuese të tipit kelzenian ku ekziston një gjykatë e ndarë kushtetuese me juridiksion të qartë, **inter alia**, për sigurimin dhe ruajtjen e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës. E cekim këtë për faktin se në vendet e Azisë ekziston një gjyqësi kushtetuese, e cila ushtrohet nga gjykatat e rregullta dhe që ka luajtur një rol të rëndësishëm në frenimin dhe kontrollin e pushtetit politik. Këtu nuk e kemi fjalën vetëm për **Japoninë**, por edhe për vendet tjera të Azisë.[36]

Edhe në rastin e fazës së tretë dhe të fundit të përhapjes së gjyqësisë kushtetuese të tipit kelsenian, e cila ndodhi siç u pa pas rrënimit të komunizmit më 1989, u vërtetua katërçipërisht se thyerjet e thella socio-politike, përmbytjet e thella revolucionare, zakonisht shtrojnë nevojën e krijimit të një mekanizmi të ndarë për të garantuar dhe promovuar se frytet e përmbysjes së thellë, të revolucionit socio-politik, të shkruara në një dokument të ri me karakter kushtetues do të ruhen nga përmbytja e serishme. Vlimet dhe përmbytjet e thella socio-politike, revolutive, kanë qenë dhe janë shkaku kryesor i përqafimit të gjyqësisë kushtetuese si një mjet i përshtatshëm për kontrollimin e pushtetit politik dhe sigurimin se ai pushtet do të ushtrohet në bazë të përcaktimeve kushtetuese. Krahas instituteve të tjera të demokracisë kushtetuese, siç janë ndarja e pushtetit, sundimi i ligjit, respektimi i të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve gjyqësia kushtetuese përbën një mekanizëm jashtëzakonisht të rëndësishëm në realizmin e demokracisë kushtetuese.

3.5. Komente dhe pyetje

3.5.1. Gjyqësia kushtetuese, siç e njohim ne sot, është zhvilluar si rezultat i ideve të **Iluminizmit** dhe racionalizmit si ideologji e tij. Sipas iluministëve, si puna e Dekartit, Llokut dhe Njutonit gjatë shekullit XVII, apo Gëtes, Volterit, Rusosë dhe Adam Smithit përgjatë shekullit XVIII, **pushteti ka burim racional**, jo burim hyjnor, **gjë që nënkupton se ai mund të organizohet, ndahet dhe kufizohet (kontrollohet) në mënyrë të përcaktuar më parë nga ana e njerëzve.** Dokumenti me të cilin kjo bëhet, quhet kushtetutë. Lindja e kushtetutave të shkruara në kolonitë e Amerikës së Veriut dhe në Francë në dekadat e fundit të shekullit XVIII ka ngritur nevojën e organizimit, ndarjes dhe kufizimit (kontrollit) të pushtetit. Instituti i kontrollit gjyqësor bën pjesë në këto përpjekje për të kufizuar (kontrolluar) pushtetin politik. Tregoni cili ka qenë shteti i parë që ka njohur kontrollin gjyqësor të legjitimitetit kushtetues të pushtetit legjislativ? Kur ka nisur kjo në Evropë? Cilat vende kanë qenë të parat që kanë eksperimentuar me gjyqësinë e ndarë kushtetuese, e cila ushtrohet nga një gjykatë jo e rregullt që ka juridiksion te veçantë kushtetues?

3.5.2. Vendet e Amerikës Latine kanë pasur një sistem të **kontrollit politik të kushtetutshmërisë** së ligjeve dhe akteve të tjera juridike. Deri kur ka zgjatur ky sistem dhe pse me këtë sistem ka nisur historia e gjyqësisë kushtetuese në këtë kontinent?

3.5.3. Kontrolli gjyqësor i kushtetutshmërisë në Amerikën Latine ka marrë **tri forma**. Cilat janë ato forma dhe cili ka qenë qëllimi primar i përqafimit të sistemit gjyqësor të kontrollit të kushtetutshmërisë në këto vende?

3.5.4. Bolivia me Kushtetutën e vitit 1826 ka qenë vendi i parë latino-amerikan që ka instaluar rrugën e kontrollit politik të kushtetutshmërisë së ligjeve. Kjo rrugë modelohej në përvojën franceze të **Senatit Konservator**. Në çka konsistonte në fillim ky kontroll politik i ligjeve boliviane dhe si u transformua më pastaj?

3.5.5. Brazili, krahas Bolivisë, ka pasur një sistem politik të kontrollit të kushtetutshmërisë. Ky sistem është ndikuar nga përvoja franceze dhe nga idetë e **Benjamin Konstant**. Cila është veçoria kryesore e sistemit politik të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve në Brazilin e viteve dyzetë të shekullit 18-të?

---

[36] Për një përmbledhje të shkëlqyer të studimeve individuale të autorëve, të cilat i referohen Azisë në përgjithësi, shih vëllimin e Albert H. Y. Chen (ed.), *Constitutionalism in Asia in Early Twenty – First Century* (Cambridge University Press: Cambridge, 2014).

3.5.6. Meksika, siç u pa, ka qenë vendi i parë latino-amerikan që ka futur kontrollin gjyqësor të kushtetutshmërisë së ligjeve, i modeluar sipas sistemit amerikan. Kjo është bërë si pasojë e ndikimit të fuqishëm amerikan në sistemin e drejtësisë. Gjendja nuk ka ndryshuar dukshëm as sot e kësaj dite. Ky ndikim amerikan në sistemin meksikan të drejtësisë lidhet me ndikimin e fuqishëm që ka pasur **Aleks de Tokvil** me librin e tij monumental **Demokracia në Amerikë.** Megjithatë, sistemi meksikan i decentralizuar i kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë ka një dallim substancial me sistemin amerikan, i cili dallim ka të bëjë me natyrën e **stare decisis** në sistemin meksikan. Kjo natyrë është shumë më e ndryshme. Pse?

3.5.7. Vendet e Amerikës Latine, në mënyrë krejt specifike, kanë qenë të parat që në kushtetutat e tyre nacionale shumë herët kanë parashikuar mjetin juridik **actio popularis** me qëllim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive individuale. Cili vend ka paraparë në kushtetutën e vet për herë të parë këtë mjet juridik dhe për çka mund të përdorej ai në praktikë?

3.5.8. Kuba me Kushtetutën e saj të vitit 1940 u bë vendi i parë në Amerikën Latine që themeloi gjykatën kushtetuese me juridiksion të veçantë kushtetues. Kjo gjykatë kushtetuese, megjithatë, në aspektin formal u themelua në kuadër të Gjykatës Supreme të Drejtësisë. Para se të bëhej kjo, pra para themelimit të gjykatës kushtetuese kubane, Gjykata Supreme bënte kontrollin e legjitimitetit kushtetues të ligjeve dhe akteve tjera juridike kubane. Ky model, megjithatë, ishte shumë më i ndryshëm se ai amerikan, aq shumë më i ndryshëm sa rrënjësisht dallonte nga modeli amerikan. Përshkruajeni këtë dallim rrënjësor në mes të modelit kuban dhe atij amerikan?

3.5.9. Para **debatit Kelsen – Shmit** ka ekzistuar një diskurs i drejtësisë, i cili në vete ka përmbajtur bërthamat e mendimit mbi gjyqësinë kushtetuese dhe që më vonë u promovua në debatin e sipërcekur. Kush kanë qenë eksponentët e këtij diskursi juridik pararendës të debatit **Kelsen – Shmit** dhe në çka ka konsistuar?

3.5.10. Hans Kelsen ka nisur shtjellimet e tij teorike që kanë të bëjnë me arsyetimin e legjitimitetit të ekzistimit të gjyqësisë kushtetuese pas themelimit të gjykatave kushtetuese në Çekosllovaki dhe **Austri**. Ai është i njohur për farkimin e termave, siç janë gjyqësia e ndarë kushtetuese nga tri pushtetet tjera, gjyqësia kushtetuese si "ligjvënës negativ", gjyqësia kushtetuese si mekanizëm për mbrojtjen e pakicës nga shumica, dhe kështu me radhë. Çfarë do të thotë termi "ligjvënës negativ" sipas **H. Kelsen**?

3.5.11. Një çështje tjetër me rëndësi që ka diskutuar **H. Kelsen** në debatin e tij me **Karl Shmit**, ka të bëjë me natyrën e shtetit federal dhe rolin e gjykatës kushtetuese në këtë mes. Cili është ky rol i gjykatës kushtetuese në realizimin e projektit shtetëror federal?

3.5.12. Në shtjellimet e tij, **K. Shmit** merr si shembull SHBA-të dhe thekson se gardiani i kushtetues atje nuk ka asnjë lidhshmëri me rastin e Gjermanisë së Vajmarit. Sipas tij, për të ardhur deri te krijimi i një gjykate të ndarë kushtetuese duhet të ndryshojë kuptimi i kushtetutës dhe i juridiksionit kushtetues të kësaj gjykate. Çfarë do të thotë kjo?

3.5.13. Pasi konstaton se gjyqësori është në tërësi i paaftë dhe jo i përshtatshëm për të qenë gardian i kushtetutës, **K. Shmit** jep edhe arsyet pse kjo ka qenë kështu në shoqërinë gjermane të kohës. Përveç kësaj, ai jep edhe emrin e organit, i cili do të ishte i vetmi gardian i kushtetutës, duke e zhvendosur fokusin nga gjyqësori gjerman në një organ të tretë, siç e quan ai, i cili ishte i veshur me pushtet neutral dhe të pavarur. Cilat janë këto arsye që në kohën në mes të dy luftërave botërore e kanë bërë gjyqësorin të papërshtatshëm për të qenë gardian i kushtetutës sipas **K. Shmit** dhe cili sipas tij është organi me pushtet neutral dhe të pavarur që mund të shërbente si gardian i kushtetutës në kohën e **Kushtetutës së Vajmarit**?

3.5.14. Gjyqësia kushtetuese **kelseniane** bazohet në ekzistimin e një organi të veçantë kushtetues, gjykatës kushtetuese, e cila ka kompetenca të qarta të përcaktuara me kushtetutë nacionale sa i përket kontrollit kushtetues të ligjeve. Më vonë, në juridiksion të gjykatës kushtetuese janë futur, përveç "ligjvënies negative", edhe kontrolli kushtetues i akteve të tjera juridike dhe mbrojtja e të drejtave dhe

lirive individuale. Ideja e gjyqësisë kushtetuese kelseniane ka nisur me idenë që të ruhet natyra demokratike e qeverisjes, ku sundimi i shumicës nuk është prerogativë e pakontrolluar, përkatësisht ku ndarja e pushteteve, sundimi i ligjit, si dhe respekti për të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve janë pjesë përbërëse e qeverisjes kushtetuese. Tregoni rastet dhe arsyet e themelimit pas vitit 1945 të gjykatave kushtetuese si organe të ndara nga gjyqësori i rregullt, me juridiksion të veçantë kushtetues?

3.5.15. Vendet e **Amerikës Latine**, pas vitit 1945, kanë pasur një zhvillim të ndryshëm sa i përket gjyqësisë kushtetuese. Ky zhvillim nuk mund të kornizohet sipas sistemit të periodizimit evropian. Tregoni modelin dominues të kontrollit kushtetues latino-amerikan dhe llojet tjera jodominante të kontrollit në fjalë?

3.5.16. Në disa vende latino-amerikane, pa marrë parasysh modelin e gjyqësisë kushtetuese që kanë përqafuar, ekziston instituti i njohur si **amparo**. Tregoni se në çka konsiston ky institut dhe në cilat vende latino-amerikane është përqafuar?

3.5.17. Në **vendet arabe**, në **vendet myslimane** dhe në vendet tjera jo demokratike, kontrolli gjyqësor i kushtetutshmërisë së ligjeve ka pasur një efekt shumë të vogël. Tregoni pse kjo është kështu?

3.5.18. Vendet ish komuniste kanë përqafuar me të madhe sistemin kelzenian të gjyqësisë kushtetuese. Ka tri arsye pse kjo ka ndodhur kështu. Tregoni cilat janë arsyet e tilla?

3.5.19. Sistemi kelsenian i përqafuar nga shumica e vendeve ish komuniste, si në Evropë ashtu dhe jashtë saj, megjithatë, ka pasur një hibridizim sepse në kuadër të juridiksionit të tyre kanë ngërthyer edhe relikte të juridiksionit të decentralizuar të modelit amerikan. Për çfarë bëhet fjalë këtu?

3.6. Lexim shtesë

- Alec Stone Sweet, "Constitutional Courts". Në Michel Rosenfeld and Andras Sajo (eds.), The *Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law* (Oxford University Press: Oxford, 2012)
- Daniel Smilow, "The Judiciary: The Last Dangerous Branch?". Në Michel Rosenfeld and Andras Sajo (eds.), *The Oxford Handbook of Coparative Constitutional Law* (Oxford University Press: Oxford, 2012)
- Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West. Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post – Coomunist Europe in a Comparative Perspective* (Kluwer Law International: The Hague, 2010)
- Jean Pierre Massias, *Droit constitutionel des Etats d'Europe de l'Est* (PRESS UNIVERSITAIRES DE FRANCE: Paris, 2008)
- Nathanj. Brown, *Constitutions in a Nonconstitutional Wolrd. Arab Basic Laws and the Prosepcts for Accountable Government* (State University of New York Press: New York, 2002)
- Levent Gonenc, *Prospects for Constitutionalism in Post – Communist Countries* (Martinus Nijhoff Publishers: The Hagues, 2002)
- Giusepper de Vergottini (ed.), *GIUSTZIA COSTITUZIONALE E SVILUPO DEMOCRATICO NEI PAESI DELL' EUROPA CENTRO – ORIENTALE* (G. Giappichelli Editore: Torino, 2000)
- Chistopher Wolfe, *The Rise of Modern Judicial Review. From Constitutional Interpretation to Judge Made Law* (Littlefield Adams Quality Paperbacks: USA, 1994)
- John Bell, *French Constitutional Law* (Clarendon Press: Oxford, 1992)

4. SISTEMET (I): DEMOKRACITË LIBERALE

Përgjithësisht. - Në këtë kapitull shtjellohen sistemet dhe modelet e gjyqësisë kushtetuese të vendeve liberale. Kjo për arsye se vetë termi gjyqësi kushtetuese lidhet pashmangshëm më këtë lloj të demokracisë kushtetuese, e cila i ka dhënë vulë qeverisjes së civilizimit perëndimor bashkëkohor.

Diskutimi natyrshëm nis me **SHBA**-në dhe historikun e saj. Kjo bëhet për disa arsye, dy ndër të cilat janë më të rëndësishme: *e para*, sepse në këtë vend ka nisur për herë të parë ideja e kontrollit gjyqësor të supremacisë (epërsisë) së kushtetutës, e kuptuar si një tekst i kodifikuar mbi rregullat e lojës politike dhe rolin e pozitën e individit në shoqëri; dhe, *e dyta*, për shkak se ky lloj i gjyqësisë kushtetuese më pastaj u përhap në **Evropë** dhe vendet e caktuara të **Amerikës Latine** dhe gjetiu.

Pas kësaj nis seksioni i dytë në të cilin diskutohet gjyqësia kushtetuese e tipit të përzier apo **hibrid**. Ky seksion, krejt natyrshëm, nis me **Portugalinë**, si i vetmi i llojit të tillë në **Evropë**. Këtu diskutohet rruga e këtij vendi kah formimi i gjyqësisë të pavarur kushtetuese, pas përfundimit të diktaturës së mesit të viteve ’80 të shekullit të kaluar. Në fillim sqarohet se në këtë vend ka ekzistuar një lloj kontrolli specifik, **ushtarako-politik**, i kushtetutshmërisë.

4.1. Sistemi amerikan

Sikundër u pa nga dy kapitujt e fundit, sistemi anglo-sakson i **të drejtës së përgjithshme (common law**) në kolonitë amerikane pati një kuptim tjetër nga ai që kishte në vendin e origjinës, në Britaninë e Madhe. Kërkesa britanike që çdo kartë (**charter**) apo kushtetutë e kolonive amerikane të jetë në pajtim me ligjvënësin britanik, i cili personifikohej me parlamentin dhe supremacinë e tij të fituar me mund përgjatë shekullit XVII në luftën e gjatë kundër monarkisë, në koloni u përkthye si supremaci (epërsi) e kushtetutave vendore kundrejt ligjeve të tjera në nivel lokal. Me pavarësimin e këtyre kolonive, kjo traditë u kristalizua përmes vendimit të njohur në rastin **Marbury vs. Madison** (1803).

Me këtë vendim u rikonfirmua dallimi thelbësor me vendin amë, Britaninë e Madhe, ku supremacia (epërsia) e parlamentit merrej si e mirëqenë. Kushtetuta e SHBA-së, e ndërtuar mbi idetë e **John Lokut** (**John Locke: 1632 – 1704**) mbi të drejtat e patjetërsueshme të njeriut, paraqiste një qasje që sovranizonte popullin. Kjo qasje u shpreh dhe materializua me fjalët ikonë të konstitucionalizmit amerikan **NE, POPULLI...** (**WE, THE PEOPLE...**). Kjo ishte e kundërt me konceptin anglez mbi supremacinë (epërsinë) parlamentare dhe nënkuptonte se disa veprime dhe sjellje nuk i lejoheshin as parlamentit sepse sovran ishte vetë populli, jo ai.

E drejta e përgjithshme në Amerikë doli të ishte ngjashëm siç kishte qenë interpretimi i kryegjyqtarit **Edvard Koke** (**Sir.Edward Cocke: 1552-1634**) në rastin **Dr. Bonham** (1603): të drejtat e patjetërsueshme, të mishëruara në traditën shekullore të së drejtës së përgjithshme në Britani kontrollonin edhe aktet ligjore të parlamentit. Këto të fundit nuk duheshin zbatuar nëse binin ndesh me të drejtën e përgjithshme. Këtë filozofi **Edvard Koke** e kishte kthyer në një standard veprimi nga frika se mund të vinte deri te restaurimi i monarkisë absolute. Këtë e kishte bërë duke ia veshur të drejtës së përgjithshme cilësinë e standardit suprem të sjelljes, përkatësisht standardin e një kushtetute britanike. Në atë kohë parlamenti kuptohej si vetë goja ligjvënëse e mbretit dhe për mbretin (doktrina **king in parlament**). Kjo nuk ishte kështu përtej Atlantikut, ani se ishte pjesë e sistemit të së drejtës së përgjithshme, në SHBA kuptimi **lokean** i të drejtës supreme (sipërore) bazohej në të drejtat e patjetërsueshme të individit që garantoheshin nga vetë natyra e njeriut. Këto të drejta të patjetërsueshme individuale në sistemin amerikan të

së drejtës së përgjithshme u futën (kodifikuan) në një kushtetutë të shkruar, vështirë të ndryshueshme, e cila duhej mbrojtur jo vetëm nga vullneti i ligjvënësit të ri amerikan, por edhe nga ekzekutivi, në të gjitha nivelet. Vënia në jetë e këtij botëkuptimi nisi me rastin e cekur më lart **Marbury v Madison**.

Rasti në fjalë, në esencë, nuk ishte asgjë tjetër pos konfirmim katërçipërisht i ideve të **John Lokut** dhe iluministëve të tjerë mbi origjinën njerëzore të pushtetit, mbi të drejtat dhe liritë e patjetërsueshme të individit dhe konceptin e ndarjes dhe balancimit së pushteteve, të cilat në mënyrë kumulative influencuan thellësisht idetë e ndërtuesve të Kushtetutës Amerikane. Këto ide lokeane ata i shprehën në 85 punimet dhe esetë e tyre, tanimë të njohura si **Letrat e Federalistit (Federalist Papers: 1787-1788)**.

Në Letrën nr. 78, më e njohura nga të gjitha, e shkruar nga **Alexander Hamilton** (**Alexander Hamilton: 1757-1804**), kontrolli gjyqësor shihet si një instrument i përshtatshëm për të ruajtur supremacinë (epërsinë) e kushtetutës kundër ndërhyrjeve të legjislativit dhe ekzekutivit amerikan. Pushteti gjyqësor, sipas tij, paraqet **pushtetin më pak të rrezikshëm** nga tri pushtetet (**the least dangerous branch**). Është i tillë, pra më pak i rrezikshëm se dy pushtet tjera, sepse është më i dobët se ta, se legjislativi dhe ekzekutivi. Kjo është kështu sepse gjyqësori nuk ka as monopolin e ushtrimit të dhunës fizike e as fuqinë e parasë. Një rrethanë e tillë e bën gjyqësorin të përshtatshëm për të interpretuar kushtetutën me qëllim të ruajtjes së supremacisë (epërsisë) së saj kundrejt çdo veprimi tjetër të pushtetit legjislativ (Kongresi) dhe ekzekutiv (Presidenti dhe Administrata). I lidhur me rregulla të rrepta të profesionit dhe me precedente gjyqësore, pushteti gjyqësor forcën e vet e merr nga fuqia e gjykimit dhe arsyetimit, jo nga forca fizike apo financiare, të cilën e posedojnë dy pushtetet tjera. Këto shtjellime të **Hamiltonit**, si dhe vulosja e tyre nga **Xhon Marshall** (**John Marshall: 1755-1835**) në rastin e **Marbury vs Madison** përbëjnë kontributin unik amerikan në sferën e teorisë politike dhe të drejtës kushtetuese komparative.

Fillimisht kontrolli gjyqësor në **SHBA** u përligjësua vetëm në nivel federal. Më pastaj, ky kontroll u shtri në të gjitha nivelet e pushtetit, si në aspektin vertikal ashtu dhe atë horizontal. Ky i dyti ka qenë dhe ngelet pika referuese më e diskutueshme, pikërisht si pasojë e faktit se përvojat me kontrollin gjyqësor të pushtetit horizontal, pra në kuadër të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, kanë qenë kuadri zhvillimor i të drejtës kushtetuese amerikane. Sot e kësaj dite, debati që zhvillohet, ka të bëjë me enigmën që kërkon përgjigje në pyetjen se si është e mundur që pushteti gjyqësori, që nuk ka asnjë bazë zgjedhore politike, të gëzojë të drejtën e interpretimit të vullnetit suprem të popullit amerikan, vullnet të cilin ky popull e ka shprehur dhe shkrirë në Kushtetutë. Në nivel vertikal, ndërkaq, kontrolli gjyqësor, të cilin e ushtrojnë gjykatat supreme të shteteve anëtare, e ka të njëjtin funksion që ka pushteti gjyqësor në nivel federal dhe që ushtrohet nga **Gjykata Supreme e SHBA**-së (**GJSSHBA**).

Ky kontroll gjyqësor, i nisur në mënyrë autonome dhe jashtë dispozitave kushtetuese, ka nisur në fillim vetëm kundruall gjyqësorit në nivel federal, për t'u shtrirë më pastaj në të gjitha nivelet e gjyqësorit amerikan. Kjo rrethanë e bën sistemin amerikan të jetë pjesë e modelit të **decentralizuar** apo **difuz** të kontrollit të kushtetutshmërisë së veprimeve të autoriteteve publike. Në këtë sistem, me fjalë të tjera, secila gjykatë ka të drejtën e interpretimit kushtetues në mënyrë të pavarur dhe autoritative, duke vënë mënjanë ligjet dhe veprimet tjera të autoriteteve publike që vlerësohet se bien ndesh me Kushtetutën federale. Lindja e këtij sistemi ka një shpjegim që lidhet me historinë e tij, si në nivelin federal ashtu dhe në nivel të shteteve anëtare.

Kontrolli kushtetues i veprimeve në nivel federal**, pra i veprimeve të ligjvënësit (Kongresit) dhe ekzekutivit (Presidenti dhe Administrata) amerikan,** bazohet në botëkuptimin e shprehur nga kryegjyqtari **Xhohn Marshall**, arkitektit ideor i **Marbury vs. Madison.** Sipas tij, Kushtetuta paraqet shprehjen më sublime të vullnetit popullor, të asaj që në Amerikë shprehet përmes vetës së parë të shumësit në fjalinë **NE, POPULLI (WE, THE PEOPLE....**). Kushtetuta, jo ligji, kontrollon çdo veprim të pushtetit legjislativ (Kongresit) dhe ekzekutiv (Presidenti dhe Administrata). Çdo pushtet buron nga vullneti i sovranit, por ushtrohet vetëm sipas Kushtetutës, asnjëherë në nënshtrim ndaj ndonjë vullneti tjetër. Në këtë mënyrë, çdo ligj dhe çdo vullnet tjetër i shprehur nga ligjvënësi amerikan si dhe çdo veprim në vijim të implementimit të vullnetit të popullit amerikan, i cili bie ndesh me vullnetin sublim të shprehur në Kushtetutën federale, nuk konsiderohet i vlefshëm dhe duhet të injorohet zbatimi i tij.

Detyrën për të treguar se çka është veprim kushtetues dhe çka nuk është, pra çka është vullneti sublim i kategorisë së parë, tanimë i njohur si **NE, POPULLI (WE, THE PEOPLE...)**, sipas nenit III të Kushtetutës, e ka vetëm gjyqësori. Është prerogativë dhe detyrë primare e gjyqësorit, ka thënë **John Marshall**, për të treguar se çka është kushtetutë e çka vullnet tjetër i legjislativit dhe ekzekutivit amerikan. Ky interpretim nuk ka ndodhur si pasojë e autorizimi shprehimor nga neni III apo ndonjë nen tjetër i **Kushtetutës Amerikane** (1787). Neni III flet për pushtetin gjyqësor në nivel federativ, i cili ushtrohet nga Gjykata Supreme lidhur me çdo **rast dhe mosmarrëveshje** (**case and controversy**) që ka bazën në ligj apo në të drejtën e përgjithshme. Cilësimi i objektit vendimmarrës të Gjykatës Supreme si "rast dhe mosmarrëveshje" e ka kuptimin që Gjykata Supreme nuk mund të japë mendime këshillëdhënëse, prerogativë të cilën e kanë gjykatat supreme në nivel të shteteve federale.

Neni III si më sipër, në praktikën gjyqësore amerikane është interpretuar lidhur me nenin VI, i cili bën fjalë për Kushtetutën si për ligjin suprem amerikan, së cilës duhet t'i nënshtrohen të gjithë pa përjashtim. Ky nen përcakton në mënyrë shprehimore se asnjë kushtetutë dhe asnjë ligj tjetër i shteteve anëtare nuk mund të jetë në kundërshtim me Kushtetutën federale, ngjashëm siç bën neni III në raport me ligjet dhe aktet tjera të nivelit federal, pra se çdo ligj apo veprim tjetër në nivel federal duhet të jetë në pajtim të plotë më Kushtetutën federale. Interpretimi përmes praktikës gjyqësore amerikane i këtyre dy neneve të Kushtetutës ka pasur për pasojë kristalizimin e sistemit amerikan të kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë, model që sot e kësaj dite ngelet i **decentralizuar** apo **difuz** për shkak se ushtrohet nga tërë gjyqësori amerikan në të gjitha nivelet (**incidenter)** gjatë procedurës së vendosjes për ndonjë rast dhe mosmarrëveshje. Këtë model e ka krijuar dhe qartësuar Gjykata Supreme përmes interpretimit të Kushtetutës me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së saj kundrejt veprimit legjislativ (Kongresit)[1] dhe ekzekutiv (Presidenti dhe Administrata),[2]duke lënë në këtë mënyrë një hapësirë të mjaftueshme për gjyqësorin në nivel të shteteve anëtare për të luajtur rolin e njëjtë. Kjo është sa i përket kontrollit kushtetues në nivel federal.

Kushtetuta e SHBA-së do të vihej në rrezik sikur **GJSSHBA** mos të kishte edhe të drejtën e **kontrollit kushtetues ndaj veprimeve të shteteve anëtare**, si të atyre që kanë natyrë legjislative, ashtu dhe të veprimeve të gjyqësorit shtetëror. Kështu, në rastin **Fletcher v Peck** (1810), Gjykata Supreme ka rrëzuar një ligj shtetëror, i cili binte ndesh me nenin I, seksioni 10, të Kushtetutës që rregullon të ashtuquajturën klauzolë kontraktuese, kurse në rastin **Martin v Hunter's Lessee** (1816) ka rrëzuar aktgjykimin e një gjykate supreme shtetërore, i cili binte ndesh me kushtetutën amerikane.

Arsyetimi i **GJSSHBA** lidhur me kontrollin kushtetues të veprimeve të shteteve anëtare si më sipër ankorohet në nenin III të Kushtetutës. Ky nen mund të kuptohet, sipas arsyetimit të saj, si bazë juridiko-kushtetuese për kontroll kushtetues të vendimeve të gjyqësorit amerikan në nivel federal, por edhe si bazë e saj juridiko-kushtetuese për të ushtruar kontroll kushtetues ndaj gjykatave supreme të shteteve anëtare. Në rastin e theksuar më lart **Martin v Hunter's Lessee**, **GJSSHBA** me të drejtë konstatoi se është rasti, jo niveli i organizimit të gjyqësorit në SHBA, ai që përcakton juridiksionin e saj. Me një fjalë, përmes këtij rasti kjo Gjykatë arriti ta shtrijë juridiksionin e vet jo vetëm ndaj gjykatave të ulëta federale por edhe ndaj gjykatave supreme të shteteve anëtare. Përmes këtij vendimi, në çështjet kushtetuese ajo i siguroi vetes një rol të gjykatës së apelit karshi gjykatave supreme të shteteve anëtare.

Baza juridiko-kushtetuese për një zgjerim të juridiksionit të Gjykatës Supreme të SHBA-së u gjet, siç u konstatua më sipër, në riinterpretimin ekstensiv të përmbajtjes së dy neneve të Kushtetutës Amerikane, të neneve respektivisht III dhe VI.

---

1 Në rastin **Cooper vs Aaron** (1958), **GJSSHBA** ka theksuar se rasti **Marbury vs Madison** ka shpallur parimin amerikan që ngrit supremacinë (epërsinë) e Kushtetutës së vendit ndaj ligjeve amerikane si parim që asnjëherë nuk është në dyshim në këtë vend. Cf. Tony A. Freyer, "Cooper v. Aaron:" Incident and Consequence. *The Arkansas Historical Quarterly* Vol. 65, No. 1 (Spring, 2006), fq. 1-6.

2 Në rastin **United States vs Nixon** (1974) është mbrojtur supremacia (epërsia) e Kushtetutës kundrejt veprimit të ekzekutivit amerikan, duke thënë se pushteti gjyqësor që ushtrohet nga **GJSSHBA** mund të ndahet me pushtetin ekzekutiv po aq sa Presidenti mund ta ndajë me gjyqësorin të drejtën e vetos.

Neni VI sanksionin supremacinë (epërsinë) e Kushtetutës, duke vënë detyrim për gjyqtarët e shteteve anëtare për respektim të Kushtetutës në të gjitha rastet kur kushtetutat dhe ligjet e shteteve anëtare bie ndesh me të. Kjo do të thotë se, gjyqtarët në nivel të shteteve anëtare, bazuar në nenin VI si më sipër, kanë të drejtën e kontrollit kushtetues të ligjeve federale. Në esencë, ky nen i detyron të gjithë gjyqtarët amerikanë në nivel të shteteve që të sigurojnë supremacinë (epërsinë) e Kushtetutës së SHBA-së. Në të njëjtën kohë, neni III i Kushtetutës, siç u cek më sipër, përcakton juridiksionin e **GJSSHBA**, jo të gjykatave të tjera. Gjyqtarët në shtetet anëtare, ndërkaq, kur vendosin sipas detyrimit nga neni VI i Kushtetutës, ata vendosin sipas juridiksionit të tyre origjinal që sanksionohet me këtë nen dhe jo me nenin III të Kushtetutës. Për pasojë, kundrejt gjykatave supreme shtetërore, në çështjet kushtetuese, **GJSSHBA** ka rangun e gjykatës së apelit, të shkallës së dytë. Kontrolli kushtetues i këtij lloji përfshin çdo veprim të gjykatave supreme të shteteve anëtare të ndërmarrë në kuadër të juridiksionit të tyre origjinal nga neni VI i Kushtetutës.

Në fillim ka pasur propozime që sistemi i ri kushtetues amerikan të mbështetet në një institucion tjetër jashtë gjyqësorit amerikan, por me funksion të njëjtë - ruajtjen e supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës. Kjo, megjithatë, nuk u pranua,[3] kështu që sot në **SHBA** kontrolli gjyqësor i decentralizuar (**difuz**) përbën një institut të rrënjosur në kuadër të sistemit të qeverisjes, ku **Gjykata Supreme** merret kryesisht me vendimmarrje për çështje të rëndësishme kushtetuese që mund të burojnë nga ushtrimi i pushtetit horizontal legjislativ (Kongresi) dhe ekzekutiv (Presidenti dhe Administrata), si dhe të atij gjyqësor dhe ekzekutiv në nivel vertikal. Në mënyrë të njëjtë veprojnë edhe gjykatat e niveleve të ulëta në nivel të Federatës apo në nivel të shteteve anëtare.

Në të gjitha rastet, kontrolli gjyqësor i kushtetutshmërisë në **SHBA** i ka dy cilësi që e dallojnë atë nga sistemi evropian i modeluar sipas ideve kelseniane: **e para**, çdo gjykatë ka të drejtë që të bëjë kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve tjera të autoriteteve publike; **e dyta**, ky kontroll asnjëherë nuk mund të bëhet në mënyrë abstrakte, përkatësisht i shkëputur nga një rast apo mosmarrëveshje konkrete. Me fjalë të tjera, kontrolli gjyqësor i kushtetutshmërisë në **SHBA** mund të ushtrohet vetëm si pjesë e një procesi gjyqësor lidhur me një rast dhe mosmarrëveshje, e assesi në mënyrë abstrakte.

T'i kthehemi tani sërish çështjes së cekur më sipër të raportit të **GJSSHBA** me gjykatat më të ulëta federale, si dhe raportin gjykatave supreme të shteteve anëtare me gjykatat tjera më të ulëta në nivel të shteteve.

Kontrolli i kushtetutshmërisë së ushtrimit të pushtetit në nivel vertikal, siç u pa, në rend të parë lidhet me kontrollin e kushtetutshmërisë së vendimeve të gjykatave supreme të shteteve anëtare. Kjo arrihet përmes procedurës ankimore (apeluese): ky kontroll kushtetues është, si të thuash, linear dhe automatik. Për dallim nga ky kontroll kushtetues, çështjet kushtetuese që lindin nga interpretimet kushtetuese të gjykatave të ulëta federale dhe ato që lindin nga interpretimi i ndryshëm kushtetues i gjykatave të ulëta në nivel shteti mund të kalojnë për vendosje në Gjykatën Supreme vetëm sipas diskrecionit të saj. Kjo nuk ka qenë kështu çdoherë. Në vitin 1988, **Kongresi Amerikan** ndryshoi praktikën e deriatëhershme, sipas së cilës çdo çështje kushtetuese e vendosur në nivel të gjykatave të ulëta federale kalonte për vendosje me ankesë (apel) në **GJSSHBA**. Që nga ky vit, kalimi i rastit për shqyrtim dhe vendosje në Gjykatën Supreme është tërësisht në diskrecionin e vetë asaj.

Diskrecioni njihet me emrin **certiorari** (shkurt: **cert**) dhe ka kuptimin e dhënies së lejes. Kjo leje jepet nga **GJSSHBA** në raste shumë të rralla. Në praktikën gjyqësore deri më tani, rastet kur zakonisht janë dhënë lejet e tilla, kanë pasur të bëjnë, **inter alia**, me sa vijon:

---

[3] Në Konventën **Kushtetuese të Filadelfisë**, mbajtur më 14 maj 1787, u hodh propozimi për themelimin e **Këshillit të Revizionit** (**Council of Revision**), i cili do të bënte kontrollin preventiv të ligjeve të **Kongresit**. Këshilli duhej të përbëhej nga gjyqtarët e **GJSSHBA** dhe Presidenti i SHBA-së. Propozimi për themelimin e tij u hodh poshtë me argumentin se gjyqësori nuk mund të përfshihet në procesin e bërjes së ligjeve. Cf. Erwin Chemerinsky, *Constitutional Law. Principles and Policies* (ASPEN: New York, 2006) fq. 37-38.

- zgjidhjen e konfliktit për kompetencë të gjykatave federale të apelit (ankimore);
- zgjidhjen e konfliktit për kompetencë në mes të një gjykate federale të apelit (ankimore) dhe një gjykate shtetërore të shkallës së fundit;
- rastet kur gjykatat e ulëta federale kanë vendosur për çështje të reja kushtetuese të një rëndësie të madhe në nivel federal;
- rastet kur gjykatat e ulëta në nivel të shtetit kanë vendosur një çështje kushtetuese ndryshe nga praktika ekzistuese e Gjykatës Supreme.

Në literaturë është vërejtur se nuk ka rregulla të rrepta të shkruara që përcaktojnë se në cilat raste jepet leja për rishqyrtim të rastit (**certiorari)**. Në praktikë, si përcaktues zakonisht kanë qenë politikat që i ndjek **GJSSHBA** lidhur me rastet për të cilat duhet dhënë leja për rishqyrtim (**certiorari**). Formulimi aktual ligjor, sipas rregullave të brendshme të procedurës së **GJSSHBA,** ka ndryshuar që nga viti 1995: tani flitet për dhënien e lejes (**certioriari**) vetëm për arsye të domosdoshme (**only for compelling reasons**), për dallim nga praktika e kaluar kur flitej për rëndësinë e madhe dhe të menjëhershme të rastit si bazë për dhënien e saj.[4]

4.2. Sistemi evropian/kelsenian

Në Evropë, në shumicën e vendeve është përqafuar modeli kelsenian i kontrollit të kushtetutshmërisë. Këtu diskutojmë vetëm për kontrollin kushtetues të ligjeve, si një cilësi dalluese e këtij sistemi nga sistemet tjera të gjyqësisë kushtetuese. Aspektet tjera të kontrollit kushtetues përfolën në fund të këtij seksioni kur të përmblidhen cilësitë e përbashkëta të këtij sistemi.

Me këtë model nënkuptohen rastet kur kontrolli kushtetues i ligjeve vendoset qoftë nga gjykatat e specializuara kushtetuese të ndara nga gjyqësori i rregullt, nga gjykatat supreme apo nga gjykatat tjera të larta që kanë dhomat e specializuara brenda tyre. Me këtë sistem zakonisht asocohet institucioni i gjykatës kushtetuese, si një gjykatë e veçantë dhe e ndarë nga gjyqësori i rregullt. Mirëpo, në kuptimin e gjerë të fjalës, në këtë sistem hyjnë të gjitha vendet që kanë procedura të gjyqësisë kushtetuese me cilësi dalluese nga procedurat tjera që zhvillohen nga gjyqësori i rregullt për rastet që nuk janë të natyrës kushtetuese por janë të një natyre civile, administrative apo penale. Janë cilësitë e rastit që trajtohet, jo institucioni brenda të cilit ndodh dhënia e drejtësisë kushtetuese, ato që dallojnë sistemin evropian/kelsenian nga sistemet tjera të gjyqësisë kushtetuese. Kontrolli gjyqësor i ligjeve kihet çdoherë parasysh kur bëhet dallimi në mes të këtij sistemi dhe sistemeve tjera të gjyqësisë kushtetuese, sepse në aspektet tjera të kontrollit të kushtetutshmërisë ka shumë përafrime të modeleve kushtetuese, aq shumë sa që është vështirë të bëhet ndonjë dallim në mes tyre. Si shembull të këtij përafrimi mund të përmendet lëmi kushtetues i lirive dhe të drejtave të njeriut: në sistemet e demokracive kushtetuese në dy anët e Atlantikut ka një praktikë që është krijuar pa qenë e kushtëzuar nga cilësitë e caktuara të sistemit nacional të gjyqësisë kushtetuese. Njëjtë vlen edhe për ndarjen e pushteteve. Ky diskutim në këtë drejtim nuk mund të shkojë më tej sepse kalon caqet e trajtimeve tona në këtë seksion. Le të diskutojmë tani për cilësitë dalluese të sistemit **evropian / kelsenian**.

Cilësia e parë e këtij sistemi është se legjitimiteti kushtetues i ligjeve në këtë sistem vendoset sipas një procedure speciale dhe në mënyrë të koncentruar, e njohur si **principlaiter**. Me një fjalë, në këtë sistem gjykatat tjera brenda sistemit të drejtësisë në nivel vendi nuk kanë të drejtë të vendosin në mënyrë meritore dhe përfundimtare për kushtetutshmërinë e ligjeve. Këtë të drejtë e ka vetëm gjykata kushtetuese.

Cilësia e dytë, në vijim sa më sipër, konsiston në atë se kontrolli **principaliter**, i koncentruar, sipas rregullit është **abstrakt**, ani se në këto sisteme krahas sistemit abstrakt të kontrollit të kushtetutshmërisë, jo rrallë, lejohet edhe kontrolli **konkret** i legjitimitetit kushtetues të ligjeve. Quhet kontroll abstrakt i

[4] Giulia Pili, "La giustizia costituzionale negli Stati Uniti d'America". Në Luca Mezzetti (ed.), *SISTEMI E MODELLI DI GIUSTIZIA COSTITUZIONALE* (CEDAM: Padova, 2009) fq. 634-637.

kontrollit të legjitimitetit të ligjeve sepse kushtetutshmëria e tyre bëhet nga palët (e autorizuara) të cilat nuk kanë nevojë ta provojnë ekzistimin e interesit juridik – kushtetues individual (personal) për vënien në lëvizje të kësaj procedure speciale apo **principaliter**. Këto palë të autorizuara zakonisht janë organet qendrore të pushtetit politik apo organet tjera jo qendrore të cilat konsiderojnë se një ligj apo disa dispozita ligjore prekin të drejtat e tyre kushtetuese **pro futuro** (në të ardhmen). Kontrollin e kushtetutshmërisë gjykata e bën, thënë shkurt, në mënyrë abstrakte dhe pa pasur para vetes asnjë rast apo mosmarrëveshje ndaj të cilës kërkohet zbatimi konkret i ligjit kushtetutshmëria e të cilit vihet në dyshim nga pala e autorizuar.

Cilësia e tretë, në këtë sistem, i cili zhvillohet sipas një procedure speciale, **principaliter**, kontrolli kushtetues mund të jetë **a priori**, para nxjerrjes dhe hyrjes në fuqi të ligjit, por edhe **a posteriori**, pas nxjerrjes dhe hyrjes së tij në fuqi. Si në rastin e parë, ashtu dhe në të dytin, fjala është për një kontroll abstrakt. Kjo është veçoria dalluese e këtij sistemi me sistemet tjera. Pra, kontrolli kushtetues i ligjit bëhet pa pasur para vetes një rast apo mosmarrëveshje ndaj të cilës duhet të bëhet zbatimi konkret i ligjit. Kjo cilësi është pasojë e rrethanës së cekur më sipër, pra se kushtetutshmëria e ligjit vlerësohet përmes procedurës speciale, **principaliter**. Kontrolli **a posteriori**, siç u tha, mund të jetë edhe **konkret**, d.m.th mund të jetë **incidenter**, pra të kryhet gjatë kohës sa zhvillohet një gjykim lidhur me një rast apo mosmarrëveshje. Kjo ndodh, në rastet kur gjatë vendosjes për një rast apo mosmarrëveshje konkrete një gjykatë e rregullt has në një çështje kushtetuese, e cila i del përpara vendosjes për rastin apo mosmarrëveshjen konkrete të natyrës administrative, civile apo penale. Me këtë rast, gjykata e tillë, në sistemin e centralizuar apo të koncentruar të gjyqësisë kushtetuese, **evropiano/kelsenian**, të cilin e diskutojmë këtu, duhet të ndalë procedurën dhe ta referojë çështjen për zgjidhje përfundimtare në gjykatën kushtetuese, në gjykatën supreme apo në gjykatën tjetër më të lartë në vend, e cila ka juridiksion përfundimtar në vendosjen mbi çështjet kushtetuese.

Së fundi, një cilësi tjetër e këtij sistemi lidhet me efektin e vendimeve gjyqësore. Këtu efekti është **erga omnes**, për dallim nga sistemi amerikan ku efekti i vendimeve gjyqësore, në parim, prodhon vetëm efekte **inter partes,** në mes të palëve. Kjo nuk do të thotë se nuk ka përjashtim nga kjo rregull. Vendimet që kanë të bëjnë me kontrollin e kushtetutshmërisë së akteve individuale të autoriteteve publike, pra jo të vendimeve me karakter juridik-ligjor, kanë efekt **inter partes**, në mes të palëve. Në sistemin amerikan, duhet theksuar se, megjithatë, si pasojë e efektit **stare decisis**, zbutet efekti **inter partes** i vendimeve, në veçanti kur flitet për vendimet e **GJSSHBA** që kanë të bëjnë me unifikimin e praktikës në nivel nacional.

Sikundër u pa më sipër, mund të jenë të ndryshme organet që e ushtrojnë këtë lloj të kontrollit kushtetues, tanimë i njohur botërisht si sistemi **evropian/kelsenian**, i cili ka cilësi të një kontrolli të koncentruar dhe që ushtrohet sipas një procedure të specializuar **principaliter**. Historikisht ky sistem fuqishëm identifikohet me organe të përcaktuara paraprakisht me kushtetutë, të cilat quhen gjykata kushtetuese, sipas emrit të vënë nga arkitekti i tyre ideor, **Hans Kelsen**. Si organe kushtetuese, gjykatat kushtetuese paraqesin trupa të veçantë dhe janë bartësit kryesorë të mbrojtjes së kushtetutshmërisë jo vetëm kur flitet për legjitimitetin kushtetues të ligjeve dhe akteve tjera juridike, por edhe të çdo veprimi (në disa vende edhe mosveprimi apo lëshimi) të autoriteteve publike. Ne flasim këtu, siç u theksua më sipër, vetëm për kontrollin kushtetues të ligjeve sepse kjo është cilësia thelbësore dhe fillestare që e dallon këtë sistem nga ai amerikan dhe sistemet tjera. Në këtë kuptim, gjykatat kushtetuese bëjnë kontrollin kushtetues të akteve më të larta të organit legjislativ. Në disa vende bëjnë, pra, edhe kontrollin kushtetues të amendamenteve kushtetuese, të cilat në momentin e votimit bëhen normë kushtetuese e barabartë me ato të cilat janë nxjerrë më herët. Në sistemin **evropian/kelsenian** kjo bëhet e mundur për shkak se gjykatat kushtetuese në vendet e këtij sistemi kanë një marrëdhënie të kufizuar me legjislativin, e cila ua mundëson atyre anulimin e ligjit sipas një procedure speciale, **principaliter**. Këto, si të tilla, janë institucione speciale të themeluara me qëllim që të ushtrojnë vendimmarrje ekskluzive në çështjet kushtetuese, ku kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjeve përbën vendimmarrjen më të rëndësishme. Kjo do të thotë se këto organe kanë monopol dhe të drejtë ekskluzive për të shërbyer si interpretuesit e fundit autoritativ të kushtetutës nacionale. Operimi i këtyre gjykatave ndodh jashtë sistemit të gjyqësorit të rregullt dhe janë në tërësi të

pavarura nga degët tjera të pushtetit, pra janë organe kushtetuese të ndara nga pushtetet tjera, me detyrë parësore ruajtjen e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës. Këtë detyrë e realizojnë duke kryer interpretimin përfundimtar dhe autoritativ të kushtetutës përmes vendimeve të cilat merren në kuadër të juridiksionit të veçantë të përcaktuar me kushtetutë. Ky juridiksion dallon qartë nga juridiksioni i çdo organi tjetër kushtetues.

Ky si më sipër është **sistemi evropian/kelsenian në kuptimin e ngushtë të fjalës**, pra ku kontrolli kushtetues i ligjeve zhvillohet nga një gjykatë e ndarë kushtetuese, e cila nuk bën pjesë në sistemin e gjyqësorit të rregullt, në një mënyrë të atillë që vendimmarrja dhe efektet e saj kryhen duke manifestuar cilësitë e veçanta të përshkruara si më sipër. Në anën tjetër, **sistemi evropian/kelsenian në kuptimin e gjerë të fjalës,** i ka të gjitha këto cilësi si më sipër, mirëpo zhvillohet nga ana e gjykatave supreme, gjykatave më të larta apo nga trupat tjerë që funksionojnë brenda këtyre gjykatave. Edhe në sistemin evropian/kelsenian në kuptimin e gjerë të fjalës kontrolli kushtetues është i centralizuar në duart e instancës më të lartë të gjyqësorit (të rregullt) në vend, procedura është abstrakte dhe bëhet sipas rregullave të veçanta**, principaliter**, kurse vendimi ka efekt **erga omnes**. U mor vesh, efektet **inter partes** janë si rregull për vendimet që kanë të bëjnë me kontrollin e kushtetutshmërisë së vendimeve individuale të autoriteteve publike. Sa i përket kësaj të fundit, në veçanti kur flitet për liritë dhe të drejtat e njeriut, sistemi amerikan ka tendencë përafrimi me sistemin evropian/kelsenian apo anasjelltas, ky i fundit çdo ditë e më shumë i ngjason atij amerikan. Përveç sferës së të drejtave të njeriut, siguria juridike në kuptim të përgjithshëm ka bërë që efekti **stare decisis** në SHBA në sferën e unifikimit të praktikës gjyqësore në nivel nacional ka krijuar përafrimin e këtij sistemi me efektet **erga omnes** të vendimeve të Gjykatës Supreme në çështjet kushtetuese. Kjo është pasojë e funksionit **nomofilatik** (unifikues i praktikës gjyqësore në nivel nacional) që ka kjo gjykatë në sistemin juridiko - kushtetues amerikan.

Janë organet ato që përcaktojnë nëse një sistem është i decentralizuar apo jo. Kjo do të thotë se, kur kontrolli kushtetues kryhet nga disa instanca, atëherë quhet i decentralizuar, kur kjo kryhet nga një gjykatë e veçantë kushtetuese, atëherë quhet model evropian/kelsenian. Ky model, pra modeli evropian/kelsenian, mund të jetë i centralizuar, siç është në fakt sipas rregullit, në raste shumë të rralla mund të jetë edhe i përzier, por në asnjë rast ekskluzivisht i decentralizuar. Sistemi evropian/kelsenian dhe sistemi amerikan janë të papajtueshëm në këtë pikë, pra në asnjë rast modeli evropian/kelsenian nuk mund të dominohet nga një decentralizim total i kontrollit kushtetues sepse kjo nuk ka kuptim në sistemin evropian/kelsenian (qoftë në kuptim të ngushtë apo në kuptim të gjerë).

4.3. Sistemi i përzier apo hibrid

Për dallim nga **Evropa**, ku dominon sistemi i centralizuar, tanimë i njohur si sistemi **evropian/keslenian** i gjyqësisë kushtetuese, **Amerika Latine** dominohet nga sistemi i përzier apo hibrid i kësaj gjyqësie. Në Evropë, vetëm Portugalia paraqitet si një model i tillë. Në këtë model, gjyqësia kushtetuese ushtrohet nga një gjykatë (qoftë gjykatë kushtetuese apo një gjykatë e rregullt e nivelit më të lartë nacional), krahas gjykatave të rregullta të të gjitha niveleve. Ky model, i cili u tha se e dominon gjyqësinë kushtetuese në **Amerikën Latine** dhe këtë e diskutojmë në kapitullin 6-të, paraqet një risi (inovacion) që nuk mund të shpjegohet as me parametrat e sistemit amerikan e as me ata të sistemit evropian/keslenian. Në këtë sistem kombinohen kontrolli gjyqësor (**judicial review**) dhe kontrolli kushtetues (**constitutional adjudication**).

Në krahasim me shtrirjen e përgjithshme të gjyqësisë kushtetuese nëpër demokracitë kushtetuese nëpër botë, ky sistem paraqitet si më i rrallë në krahasim me dy sistemet tjera. Ai, megjithatë, ka identitet dhe natyrë autonome e të pavarur nga dy sistemet tjera. Historia e këtij sistemi ka treguar, siç pamë në kapitullin pararendës dhe në kapitullin në vijim që flet për gjeografinë e gjyqësisë kushtetuese, vendet rrëshqasin në drejtim të sistemit evropian (të centralizuar) ose atij amerikan (të decentralizuar) të gjyqësisë kushtetuese. Kjo nuk do të thotë se përqafimi i këtij sistemi është bërë për qëllime efemere dhe të përkohshme: krejt e kundërta, siç u tha, ky sistem ka identitet dhe fizionomi autonome dhe të pavarur nga dy

sistemet tjera dhe përqafimi i tij është bërë me qëllim të funksionimit simultan të sistemit të centralizuar dhe të decentralizuar të gjyqësisë kushtetuese.[5] Nga hulumtimet e kahershme mbi gjyqësinë kushtetuese, duke u mbështetur në autorin me nam të gjyqësisë kushtetuese, **Mauro Kapelleti** (**Mauro Cappelletti: 1927-2004**), në literaturë është vërejtur se përqafimi i sistemit **hibrid** reflekton qëndrueshmërinë e ndikimit amerikan dhe vështirësitë e ruajtjes në vendet me sistem juridik kontinental (civil), në njërën anë, dhe vështirësitë ekzistuese të ambientit latino-amerikan për vënien në jetë të konstitucionalizmit dhe të gjyqësisë kushtetuese të centralizuar, në anën tjetër.[6]

Vlen të theksohet se sistemi i përzier apo hibrid latino-amerikan i gjyqësisë kushtetuese ka lindur kryesisht si rezultat i ndikimit të madh të **SHBA-së** në zhvillimin kushtetues të këtyre vendeve pas dekolonizimit, në një mënyrë krejt evolutive. Veç kësaj, ky sistem është krijuar edhe si rezultat i përqafimit të tij në mënyrë shprehimore dhe me vetëdije në tekstet kushtetuese të vendeve latino-amerikane.

Në kuadër të sistemit evropian të gjyqësisë kushtetuese funksionon edhe gjyqësia kushtetuese e **Portugalisë**, si një model i përzier apo hibrid, i vetmi i këtij lloji në kontinent. Në pikëpamje institucionale ky vend bën pjesë në sistemin **evropian/kelsenian** për shkak se posedon një gjykatë kushtetuese me juridiksion të veçantë dhe të qartë kushtetues, e ndarë nga sistemi i rregullt gjyqësor – **Tribunali Kushtetues i Portugalisë** (**TKPo**). Fizionomia kelseniane e gjyqësisë kushtetuese të këtij vendi sanksionohet përmes dy llojeve të dispozitave kushtetuese të **Kushtetutës së Portugalisë** (1976): nenet 221-224 ["Gjykata Kushtetuese"] flasin për kuptimin, përbërjen, përgjegjësitë, organizimin dhe procedurën e **TKPo**, kurse në nenet 202-218 ["Gjykatat"] flasin për gjyqësorin e rregullt portugez. Cilësia e sistemit evropian të gjyqësisë kushtetuese këtu mbaron dhe nis të shpërfaqet modeli i përzier apo **hibrid**, i cili ankorohet në dispozitat e neneve 204 dhe 221 të Kushtetutës. Të shohim si duket kjo në vijim.

Neni 204 urdhëron të gjitha gjykatat e rregullta që asnjëherë mos të zbatojnë ligjet që janë kundër dispozitave dhe parimeve të Kushtetutës, kurse neni 221 e definon **TKPo** si një gjykatë me përgjegjësi specifike për administrim të çështjeve që kanë natyrë ligjore dhe kushtetuese. Neni 204 sanksionon sistemin amerikan kurse neni 221 sistemin **evropian/kelsenian**: të dyja së bashku përbëjnë esencën e sistemit portugez të gjyqësisë kushtetuese. Si i tillë, ky sistem ka disa specifika që e dallojnë si nga njëri ashtu edhe nga tjetri sistem. Të shohim se çfarë specifikash ka ky sistem krahasuar me të tjerët, meqë i kësaj natyre është i vetmi në **Evropë**. Fakti që **Portugalia** ka një gjykatë të ndarë kushtetuese, nuk ndryshon asgjë në këtë mes. Fundja, në shumë vende të **Amerikës Latine**, që është djepi i sistemit të përzier apo **hibrid** të gjyqësisë kushtetuese, ekzistojnë gjykata të ndara kushtetuese apo gjykata supreme (të larta) në kuadër të gjyqësorit të rregullt, por që posedojnë juridiksion të qartë kushtetues në sferën e kontrollit të centralizuar të kushtetutshmërisë. Kjo rrethanë, megjithatë, nuk i kualifikon këto vende në sistemin e centralizuar të gjyqësisë kushtetuese por në sistemin e përzier apo **hibrid**. Nuk është vetëm zgjidhja kushtetuese institucionale ajo që përcakton modelin, por edhe mekanizmi kushtetues juridiksional që ushtrohet për kontrollin e kushtetutshmërisë. Për të qenë një model i tipit evropian/kelsenian, ai duhet domosdo të posedojë një gjykatë të ndarë kushtetuese kurse për t'u cilësuar si model i përzier apo hibrid kjo nuk është e domosdoshme. Në **Amerikën Latine**, ku dominon modeli i përzier apo hibrid, ekzistojnë kryesisht gjykata supreme (të larta) në të cilat ankorohet me kushtetutë juridiksioni i centralizuar i kontrollit të kushtetutshmërisë. Vendet e **Amerikës Latine** i diskutojmë në kapitullin e gjashtë, në detaje, në një mënyrë historike dhe në aspektin aktual. Nga trajtimi ynë atje, mund të shihet qartë trajektorja e zhvillimit historik të vendeve latine-amerikane, në fillim kryesisht nën ndikimin e fuqishëm amerikan, por më pastaj edhe nën ndikimin evropian (kryesisht nën ndikimin italian, spanjoll dhe portugez). Në atë kapitull të këtij libri do të shihen **modelet latine-amerikane**

[5] Allan Brewer-Carías, "La jurisdicción constitucional en América Latina" [Latin American constitutional jurisdiction]. Në Domingo García Belaúnde & D. Fernández Salgado (eds.), *La jurisdicción constitucional en Iberoamérica* (Dykinson: Madrid, 1977) fq. 119-161 në fq. 123.

[6] Keith S. Rossen, "Judicial Review in Latin America".*Ohio State Law Journal* Vol 35 No. 4 (1974) fq. 785-819 në fq. 788.

të gjyqësisë kushtetuese të centralizuar me dhe pa gjykatë të ndarë kushtetuese, si dhe modelet e përziera apo **hibride** nën ndikim të fuqishëm amerikan: të parat janë trashëgimi evropiane, kurse të dytat amerikane.

T'i kthemi tani sërish rastit portugez, me fokus të veçantë në historinë e lindjes së gjyqësisë kushtetuese në këtë vend.

Në seksionin 3.3. të kapitullit pararendës të këtij libri kemi folur për **Portugalinë** dhe sistemin e saj, si pjesë e valës së dytë të zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese pas mbarimit të **Luftës së Dytë Botërore**. Në këtë vend ka pasur një diktaturë të gjatë ushtarake dhe, për pasojë, demokratizimi në mesin e viteve '70 të shekullit të kaluar u reflektua edhe në zgjidhjet kushtetuese sa i përket sistemit dhe modelit të gardianit të kushtetutës. Deri më 1982, në **Portugali** ka ekzistuar një lloj **kontrolli politiko-ushtarak i kushtetutshmërisë** së ligjeve, i cili kryhej nga nja komision i çuditshëm kushtetues. Një qasje e tillë ka qenë e kushtëzuar nga rrethanat specifike të ndikimit të ushtrisë në jetën politike të këtij vendi. Në të njëjtën kohë, frika nga rikthimi i diktaturës ushtarake në këtë vend është reflektuar edhe në zgjidhjet kushtetuese sa i përket organeve të kontrollit kushtetues dhe vetë modelit të tij përfundimtar.

Në vijim të konstatimit si më sipër, jo rastësisht, neni 161 [Përgjegjësitë e Asamblesë së Republikës"] i Kushtetutës ia njeh Parlamentit kompetencat e vëzhgimit, përkatësisht kompetencat e të qenit vigjilent në sensin e shikimit nëse veprimet e ekzekutivit dhe administratës portugeze janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet e vendit. Ky është kontroll politik i pastër dhe zanafillën e vet e ka në kohën e **Francës** së pas Revolucionit të vitit 1789 kur kontrolli i ligjeve bëhej nga trupa të rinj revolucionarë të krijuar brenda ligjvënësit francez.

Kjo qasje e e modeluar sipas përvojës franceze te kushtetutëbërësit portugezë vërehet akoma më hapur nëse shikohen dispozitat kushtetuese, të cilat flasin për statusin, rolin dhe zgjedhjen e presidentit të Republikës. Në nenin 127.3 ["Marrja e Detyrës dhe Betimi"] të Kushtetutës bëhet fjalë për mbrojtjen dhe respektimin e Kushtetutës nga ana e shefit të shtetit si dhe për zotimin e tij/saj për t'i detyruar të tjerët që ta respektojnë atë. Me këtë formulim, Presidenti në njëfarë mënyre i ngjason konceptit shmitian të gardianit të kushtetutës. Kjo për arsye se Kushtetuta e vë presidentin në pozitën e gardianit të kushtetutës. Formulimi i këtij neni, megjithatë, duket se më shumë ka të bëjë me një situatë të kundërt me atë që ka menduar **Karl Shmit** (**Carl Schmitt: 1888-1985**): nisur nga historia e dhunshme e këtij vendi, ky rol kushtetues i shefit të shtetit ka për qëllim pengimin e rikthimit të autorizimeve diktatoriale presidentit, diçka krejt e kundërt me qasjen dhe botëkuptimin shmitian ku shefi i shtetit vishet me prerogativa të gardianit të kushtetutës me qëllim të rritjes së autorizimeve diktatoriale, jo me qëllimit të pengimit të rikthimit të diktaturës. Si e tillë, kjo zgjidhje kushtetuese portugeze përbën një relikt të së kaluarës autoritare portugeze dhe rrethanave historike të nxjerrjes së Kushtetutës së vitit 1976. Në rastin e **Karl Shmit** dhe angazhimit të tij për shefin e shtetit si gardian i kushtetutës, ndërkaq, fjala është për glorifikimin e diktaturës së shefit të shtetit si përfaqësues i vetëm i vullnetit konkret politik të popullit gjerman dhe, për pasojë, si i vetmi gardian i këtij vullneti popullor të shprehur në kushtetutë.[7]

---

[7] Në fakt, **Karl Shmit** kishte shprehur idetë e tij admiruese për diktaturën e **fuhrer**-it (liderit) shumë kohë para ardhjes së **Hitlerit** në pushtet. Si apogjet të diktaturës, **Karl Shmitin** e hasim qysh më 1921, në shtjellimet e tij të shprehura në librin me titull **Mbi Diktaturën**. Këto shtjellime më vonë i ka elaboruar deri në hollësi në veprën e tij monumentale **Teoria kushtetuese** (1928). Pas ardhjes së **Hitlerit** në pushtet më 1933, **Karl Shmit** edhe konkretisht shprehet në favor të shefit të shtetit si gardian i kushtetutës dhe si institucion i vetëm që shpreh vullnetin sublim konkret të krejt popullit gjerman. Në fakt, pas ardhjes së **Hitlerit** në pushtet, **Karl Shmit** flet për **fuhrer**-in si për institucionin e vetëm që shpreh dhe përfaqëson vullnetin konkret politik të krejt popullit gjerman dhe gardianin e vetëm të këtij vullneti. Me kushtetutë, sipas tij, nënkuptohet akti konkret i vullnetit politik të krejt popullit gjerman, kurse me të drejtë kushtetuese, sipas tij, nënkuptohet e drejta për amendamentim të këtij vullneti konkret politik të krejt popullit gjerman. Kjo, në terma praktikë, do të thotë se gardiani i kushtetutës, **fuhrer**-i, në të njëjtën kohë pasqyron shprehjen e këtij vullneti konkret sublim dhe është vetë realizimi i tij në praktikë. Një qasje si kjo, në fund, e bën të panevojshme dhe absurde ekzistimin e një organi kushtetues të veçantë që do të kujdesej për mbrojtjen dhe sigurimin e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës. Për teorinë e diktaturës, cf. Carl Shcmitt, *Dicatorship* (Polity Press: UK and USA, 2014); Për teorinë kushtetuese, cf. më shumë Carl Schmitt, Constitutional Theory (Duke University Press: USA, 2008); Për rolin e **fuhrer**-it si gardian i kushtetutës pas ardhjes së **Hitlerit** në pushtet, cf. Carl Schmitt, *On the Three Types of Juristic Thought* (Preager: USA, 2004).

Përveç në zgjidhjet kushtetuese që lidhen me rolin dhe pozitën e shefit të shtetit, rrethanat historike kanë kushtëzuar edhe lindjen e modelit portugez të gjyqësisë kushtetuese. Ky model i veçantë juridiksional i kontrollit kushtetues në këtë vend ushtrohet nga gjykatat e rregullta dhe nga **TKPo**. Kjo ka nisur në vitin 1982, kur u themelua **TKPo**, i cili vepronte krahas organeve të kontrollit jojuridiksional (politik), përkatësisht krahas parlamentit dhe presidentit. Kjo zgjidhje, siç u konstatua, vjen si pasojë e rrethanave krejt të pasigurta të zhvillimit të demokracisë kushtetuese në këtë vend në mesin e viteve '70 të shekullit të 20-të. Në këtë kohë, ende kanë ekzistuar institucione kushtetuese gjysmë ushtarake, specifike dhe të çuditshme, të cilat kanë ushtruar autorizime të kontrollit kushtetues të ligjeve, akteve të tjera juridike si dhe të dhe veprimeve të ekzekutivit dhe administratës shtetërore. Nuk ka asnjë dyshim që frika e krijuar nga këto rrethana të pasigurta të zhvillimit të demokracisë kushtetuese ka pasur për pasojë dhënien parlamentit dhe presidentit të kompetencave të vëzhgimit dhe mbrojtjes së Kushtetutës së vitit 1976. Këto kompetenca nuk janë të natyrës juridiksionale, por politike.

Kompetencat juridiksionale janë vënë në jetë pak më vonë, më 1982, kur është themeluar **TKPo**. Deri më 1982 ka ekzistuar kontrolli i decentralizuar apo **difuz**, të cilin historikisht e kanë ushtruar gjykatat e rregullta. Kjo është vërejtur në kapitullin pararendës të këtij libri. Pas shumë hezitimeve dhe frikës reale se organet politike si parlamenti dhe presidenti mund të kthehen në armiq të Kushtetutës, ashtu siç ka profetizuar **Hans Kelsen** (**Hans Kelsen: 1881-1973**) në mesin e viteve '20 të shekullit të kaluar, sovrani portugez, i motivuar nga përvoja e hidhur nga e kaluara, zgjodhi modelin evropian/kelsenian të kontrollit kushtetues, duke formuar më 1982 organin e ndarë dhe të specializuar në çështjet kushtetuese me autorizime origjinare të kontrollit të centralizuar kushtetues të ligjeve dhe të akteve tjera juridike. Ky model, në fakt, paraqet një sistem të çuditshëm sepse, siç u tha, involvon disa organe politike (parlamentin dhe presidentin) dhe juridiksionale (gjyqësorin e rregullt dhe **TKPo**). Në të njëjtën kohë, **TKPo**, i cili bën pjesë në këtë sistem juridiksional të përzier në mënyrë të çuditshme, ka një juridiksion që dukshëm e dallon nga gjyqësia kushtetuese kelseniane në kuptimin e ngushtë të fjalës. Kjo vjen si pasojë e llojit të kontrollit kushtetues.

Në Portugali ekzistojnë katër lloje të kontrollit kushtetues: 1. **kontrolli kushtetues preventiv**; 2. **kontrolli kushtetues abstrakt *a posteriori*** ; 3. **kontrolli kushtetues konkret *a posteriori***; dhe 4. **kontrolli kushtetues për lëshim (mosveprim).**

Gjykatat e rregullta prononcohen në shkallë të parë lidhur me kontrollin konkret të kushtetutshmërisë, duke eliminuar kundërthënien eventuale në mes të Kushtetutës dhe normës juridike që duhet ta zbatojnë në rastin konkret. Kjo e drejtë e gjykatave buron nga urdhri i dispozitës kushtetuese të nenit 204 që u cek më sipër. **TKPo**, përveç që e ka pushtetin, e ka edhe detyrimin kushtetues që të gjykojë përfundimisht lidhur me kërkesat kundër vendimeve të gjyqësorit të rregullt lidhur me çështjet kushtetuese. Kjo kompetencë përcaktohet me nenin 280, pikat "a" dhe "b" ["Kontrolli Specifik i Kushtetutshmërisë dhe Ligjshmërisë"] të Kushtetutës. Pika "a" i jep tagrin **TKPo** për të kryer kontrollin kushtetues të një vendimi konkret gjyqësor në rastet kur gjykata që ka vendosur për rastin ka refuzuar zbatimin e një norme ligjore në emër të jo kushtetutshmërisë së saj, kurse pika "b" përcakton të kundërtën e kësaj, përkatësisht se **TKPo** kryen kontrollin kushtetues të vendimit konkret gjyqësor edhe në ato raste kur ka ndodhur zbatimi i normës ligjore kushtetutshmëria e së cilës është ngritur gjatë procedurës konkrete në të cilën është marrë vendimi.

Këto dy situata, si më sipër, i japin sistemit portugez karakterin e decentralizuar apo **incidenter** të kontrollit të kushtetutshmërisë. Krahas kësaj, në tri llojet tjera të kontrollit, **TKPo** ka juridiksion ekskluziv apo **principaliter**, të cilin nuk e ndan me asnjë organ tjetër kushtetues.

Lloji i parë i juridiksionit ekskluziv, **principaliter**, ka të bëjë me kontrollin preventiv të kushtetutshmërisë së normës juridike. Sipas nenit 278 ["Kontrolli Paraprak i Kushtetutshmërisë"] të Kushtetutës, ky kontroll kryhet para hyrjes në fuqi të normës dhe ka natyrë të **kontrollit abstrakt** sepse objekt kontrolli kushtetues është **norma juridike joperfekte** (**e pakryer**). Është abstrakt sepse, me rastin e kontrollit të saj **TKPo,** fare nuk merr parasysh rrethanat konkrete të asnjë rasti apo mosmarrëveshjeje ndaj së cilës

duhet të zbatohet norma e tillë të të ardhmen. Në të njëjtën kohë, subjektet që legjitimohen si palë të autorizuara, Presidenti dhe Qeveria, nuk kanë nevojë të provojnë ekzistimin e ndonjë interesi juridik për t'u legjitimuar si palë në këtë procedurë. Quhet normë jo perfekte (e pakryer) sepse akoma nuk ka hyrë në fuqi, gjë që nënkupton se, në momentin e hapjes së kësaj procedure, pezullohet hyrja në fuqi e tekstit juridik që përmban normën kushtetutshmëria e të cilës vlerësohet. Ky lloj i kontrolli preventiv në **Portugali** ka nisur nën ndikimin e **Kushtetutës së Francës** të vitit 1958.[8]

Aktet juridike që mund të jenë objekt i këtij lloj kontrolli kushtetues, pra objekt i kontrollit preventiv janë ligjet, dekretligjet, dekretet, rregullat juridike në nivel regjional që nxirren për zbatim të ligjeve të Republikës, si dhe marrëveshjet ndërkombëtare që nuk kanë hyrë në fuqi. Në rast se **TKPo** gjen se këto akte juridike janë kundërkushtetuese, atëherë efektet juridike të këtij prononcimi dallojnë në vartësi të aktit kundërkushtetushmëria e të cilit është konstatuar. Në rastet e kundërkushtetutshmërisë së ligjeve, dekretligjeve, dekreteve dhe rregullave juridike në nivel regjional si dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare, atëherë Presidenti dhe Qeveria duhet ta vënë veto suspensive sa i përket hyrjes së tyre në fuqi. Sa i përket dekreteve të qeverisë, ato kthehen prapa dhe anulohen, pra nuk mund të miratohen fare. Aktet tjera si më sipër, përveç dekreteve, mund të miratohen vetëm nëse pësojnë ndryshime sipas gjetjeve të shqiptuara me vendim të **TKPo**. Miratimi i tyre në formën e vjetër, si dhe hyrja në fuqi, mund të bëhet, sipas nenit 279 [Efektet e Vendimeve] të Kushtetutës, vetëm nëse ekziston një votim pro tyre i shumicës së dy të tretave prezent gjatë votimit ose i shumicës absolute. Kjo rregull mbi mbivotimin e një akti juridik të vlerësuar si kundërkushtetues vlen si për aktet e parlamentit nacional ashtu edhe për asambletë në nivel regjional. Zakonisht gjetjet e **TKPo** respektohen dhe aktet juridike si më sipër pastrohen nga dispozitat kundërkushtetuese dhe kalohen me votim në procedurë të zakonshme për miratimin e tyre. E njëjta vlen edhe për dekretet, të cilat zakonisht pastrohen dhe rimodelohen sipas gjetjeve të **TKPo.**

Lloji i dytë i juridiksionit ekskluziv, juridiksioni **principaliter,** të cilin e ushtron **TKPo,** ka të bëjë me **kontrollin kushtetues abstrakt a posteriori**. Ky juridiksion rregullohet me nenin 281 ["Kontrolli Abstrakt i Kushtetutshmërisë dhe Ligjshmërisë"] të Kushtetutës dhe përfshin, siç vërehet, edhe kontrollin e ligjshmërisë. Në këtë libër nuk flasim për kontrollin e ligjshmërisë sepse nuk i takon natyrës së tij.

Në pikën 1 të nenit 281 të Kushtetutës thuhet shprehimisht se **TKPo** mund ta ushtrojë kontrollin kushtetues dhe të shpallë si jo kushtetuese me efekt të përgjithshëm detyrues, **erga omnes,** normat me karakter të përgjithshëm**.** Nga redaktimi i kësaj dispozite del se objekt i kontrollit kushtetues mund të jenë të gjitha normat juridike, primare dhe sekondare, si ato të natyrës juridiksionale ashtu dhe ato natyrës administrative. Thënë ndryshe, sipas redaktimit të dispozitës në fjalë, del se objekt kontrolli kushtetues abstrakt a posteriori mund të jetë çdo normë e përgjithshme juridike, pra përveç akteve politike.

Siç mund të merret me mend, **kontrolli kushtetues abstrakt a posteriori** është i koncentruar sepse kryhet vetëm nga **TKPo** si një organ që ka juridiksion origjinal të drejtpërdrejtë. Si palë të autorizuara që legjitimohen, janë organet qendrore të Republikës (Presidenti, Qeveria, Kryetari i Asamblesë, Ombudspersoni dhe Kryeporkurori i Shtetit). Ky lloj kontrolli është i pavarur nga kontrolli konkret i kushtetutshmërisë, përveç rasteve kur një kontroll konkret mund të kthehet në **kontroll abstrakt a posteriori,** duke bërë të mundur që edhe kontrolli konkret, i cili çdo herë është **a posteriori**, pra pas hyrjes në fuqi të ligjit, të prodhojë efekte të përgjithshme, **erga omnes**. Një mundësi e tillë ekziston mbi bazën e pikës 3 të nenit 281 të Kushtetutës, e cila thotë se kur kjo gjykatë tri herë në rastet konkrete individuale ka shpallur një normë si jo kushtetuese, atëherë një shpallje e tillë do të ketë efekt të përgjithshëm, erga omnes, njëjtë siç ka vendimi i Tribunal Kushtetues ne rastet e **kontrollit abstrakt a posteriori**. Me këtë dispozitë, Kushtetuta ka bërë një lloj zgjidhje koordinuese në mes të sistemit të kontrollit konkret dhe atij abstrakt të kushtetutshmërisë duke iu garantuar prononcimeve të llojit të parë një efekt të përgjithshëm, **erga omnes**, në mënyrë të njëjtë siç ndodh në sistemet e kontrollit abstrakt.

[8] Luisa Azzena, "La giustizia costituzionale in Portogallo". Në J. Luther - R. Romboli - R. Tarchi (eds.), *Esperienze di giustizia costituzionale*: *Portogallo, Spagna, Belgio, Russia Polonia, Romania, Ungheria*. Tommo II (Giappichelli: Torino, 2000) fq. 268.

Lloji i tretë i kushtetutshmërisë është **incidenter** sepse kryhet nga **TKPo** vetëm pasi si rast të ketë lindur gjatë një procedure (civile, administrative apo penale) pranë një gjykate të rregullt. Ky njihet si **kontrolli kushtetues konkret a posteriori.** Në ndërkohë që kontrolli preventiv i kushtetutshmërisë për nga natyra e vet asnjëherë nuk mund të jetë pos abstrakt, kontrolli **a posteriori** i kushtetutshmërisë mund të jetë si abstrakt ashtu dhe konkret. Kjo u pa më sipër. Kontrolli **a posteriori** quhet se është abstrakt atëherë kur ushtrohet nga një gjykatë kushtetuese e veçantë, e ndarë nga gjyqësori i rregullt, në rrugë **principaliter**, pra si kompetencë ekskluzive e kësaj gjykate, kurse kontrolli konkret **a posteriori** ekziston atëherë kur ushtrohet në rrugë **incidenter** përmes referimit të rastit në gjykatën kushtetuese si një gjykatë e veçantë, pra si kompetencë joekskluzive e saj. Kjo është kështu edhe në **Kosovë**, **Itali**, si dhe në vendet tjera të Evropës dhe më gjerë dhe paraqet një relikt të sistemit të kontrollit të decentralizuar të kushtetutshmërisë.

Kjo kompetencë e kontrollit konkret **a posteriori** në **Portugali** ka ngelur në fuqi si trashëgimi nga përvoja me **Kushtetutën e vitit 1911**. Aktualisht, siç u tha më herët, sanksionohet me nenin 204 të Kushtetutës, i cili i detyron të gjitha gjykatat që të mos zbatojnë asnjë normë juridike në një rast konkret nëse çmohet se me zbatimin e saj cenohen normat apo parimet kushtetuese. Në këto raste, gjykatat e rregullta nuk kanë fare nevojë që t'i drejtohen **TKPo.** Kjo pjesë është kontroll kushtetues i decentralizuar apo **difuz** për faktin se kryhet nga vetë gjykatat e rregullta.

Sistemi portugez, megjithatë, dallon për dy arsye nga sistemet tjera të decentralizuara apo **difuze** të kontrollit kushtetues. E para, në sistemin amerikan, Gjykata Supreme e thotë fjalën e fundit për sa i përket çështjeve kushtetuese dhe ky prononcim ka efekt **erga omnes**, i cili shkaktohet si rezultat i doktrinës **stare decisis.** Në sistemin portugez, kjo vlen vetëm sa i përket raportit vertikal të Gjykatës Supreme të këtij vendi me gjykatat e ulëta, assesi në lidhje me çështjet kushtetuese, por vetëm kur flitet për çështjet administrative, civile dhe penale nga juridiksioni i përgjithshëm. Thënë shkurt, funksioni **nomofilatik** (unifikues i praktikës gjyqësor në nivel nacional) i **Gjykatës Supreme të Portugalisë** (**GJSPo**), për dallim nga Gjykata Supreme e SHBA-së, përfshin vetëm çështjet e juridiksionit të përgjithshëm të natyrës administrative, civile dhe penale. E dyta, çështjet kushtetuese trokasin në derën e **TKPo** përmes rrugës **incidenter**, qoftë sipas ankesës së palëve konkrete apo ankesës së ushtruar nga Zyra e Prokurorit Publik. Kjo përcaktohet qartë me nenin 280. 3 &4 ["Kontrolli Specifik i Kushtetutshmërisë dhe Ligjshmërisë"] të Kushtetutës. Me rastin e vendosjes për ankesën nga pikat 3 dhe 4 të nenit si më sipër, megjithatë, **TKPo** nuk ka asnjë autorizim që të merret me brendinë e rastit konkret që pritet të vendoset nga gjykatat e rregullta, por vetëm me çështjet kushtetuese, të cilat ngrihen gjatë procedurës pranë gjykatave të rregullta.

Çështjet e ngritura kushtetuese mund t'i referohen, sipas këtyre dispozitave kushtetuese një norme juridike, e cila nuk është zbatuar nga gjykatat e rregullta për shkak të dyshimeve në kushtetutshmërinë e saj dhe, anasjelltas, një norme juridike, e cila është zbatuar nga gjykatat e rregullta përkundër faktit se pala ka ngritur dyshimet në kushtetutshmërinë e saj. Këtu nuk ka rëndësi, siç u cek më herët, se për çfarë norme juridike bëhet fjalë: ajo mund të jetë çdo normë e sjelljes e cila gjendet në legjislacionin primar, sekondar apo në ndonjë tekst juridike më i ulët se këto dyja. Efektivisht kjo përjashton vetëm kontrollin kushtetues të akteve (veprimeve) politike.

Kontrolli i llojit të katërt dhe të fundit, **kontrolli kushtetues për lëshim (mosveprim)** përbën, në aspektin material, një vijë të hollë dhe vështirë të dallueshme në mes të kontrollit politik dhe jopolitik të kushtetutshmërisë. Kjo është kështu jo vetëm në rastin e Portugalisë. Sot, në përgjithësi, shtrohet si një dilemë arsyeshmëria e futjes së dispozitave kushtetuese mbi kontrollin e kushtetutshmërisë së një veprimi që nuk është ndërmarrë akoma nga organi legjislativ. Kjo, në njëfarë mënyre, e bën të çuditshëm sistemin **evropian/kelsenian** kudo që ai zbatohet dhe, në të njëjtën kohë, e bën edhe më të dallueshëm nga sistemi amerikan në të cilin as që mund të paramendohet jo kushtetutshmëria për shkak të lëshimit në sferën e ligjvënies. Dispozitat mbi lëshimin kushtetues në Portugali ekzistojnë si rrjedhojë e natyrës programatike të Kushtetutës së vitit 1976, natyrë që ka lindur në kontekstin e rrethanave postrevolucionare të mesit të viteve '70 të shekullit të kaluar. Kjo zgjidhje e kushtetutëbërësit portugez ka shkuar kundër parimit të sovranitetit parlamentar dhe disa herë politika ka dashur ta eliminojë institutin e kon-

trollit kushtetues për lëshim (mosveprim), në ndërkohë që doktrina e ka cilësuar si diçka që i shërben mirëmbrojtjes së drejtave themelore.[9]

Janë dispozitat e nenit 283 ["Jokushtetutshmëria përmes Lëshimit"] të Kushtetutës që rregullojnë këtë institut në sistemin protugez. Nga pika e parë e këtij neni qartë shihet se lëshimi kushtetues i referohet mosndërmarrjes së "masave legjislative" nga ana e organeve kompetente. Këto masa legjislative kanë të bëjnë, në rend të parë, me Parlamentin dhe mosnxjerrjen e ligjeve nga ana e tij. Në këto masa hyjnë edhe dekretligjet dhe dekretet legjislative regjionale. Këto masa kanë natyrën e legjislacionit implementues të Kushtetutës së Portugalisë me qëllim të bërjes së ekzekutueshme të dispozitave të saj. **TKPo** me rastin e vendosjes lidhur me cenimin e kushtetutës si pasojë e lëshimit për të ndërmarrë "masa legjislative" vetëm bën certifikimin e lëshimit, asgjë tjetër. Ai nuk ka asnjë instrument me të cilin të detyrojë ligjvënësin e çdo lloji për ta vënë në jetë verdiktin e vet. Me fjalë tjera, vendimi në rastin e shkeljes së Kushtetutës për lëshim (mosveprim) të organit legjislativ nacional ka natyrë juridike deklarative sepse me te vetëm zbulohet një lëshim dhe bëhet konstaimi (vërtetimi) i këtij lëshimi pa pasur asnjë mundësi të vënies në jetë të verdiktit. Kjo është e natyrshme sepse në rast se **TKPo** do të kishte pasur mundësi apo instrumente detyrimi për veprim të organit legjislativ, atëherë ai do të ishte barazuar me ligjvënësin portugez dhe do të kishte shërbyer si një substitut (zëvendësim) i këtij ligjvënësi.

4.4. Vendet nordike

Sistemi amerikan i gjyqësisë kushtetuese, i kontrollit të tërthortë të kushtetutshmërisë nga ana e të gjitha gjykatave dhe në çdo nivel gjatë vendosjes për një rast dhe mosmarrëveshje konkrete, përkatësisht vendosje përmes rrugës së tërthortë apo **incidenter,** me përjashtim të **Greqisë** dhe të disa vendeve skandinave, në **Evropë** nuk ka arritur të fitojë ndonjë vend të spikatur.[10] Kjo gjendje ka rrjedhë si pasojë e reputacionit të madh të organit legjislativ në traditën evropiane. Kjo traditë, për më tepër, ka bërë që në disa vende evropiane edhe fare mos të ekzistojë kontrolli gjyqësor i kushtetutshmërisë. E kemi fjalën këtu për **Britaninë e Madhe**[11] dhe **Holandën.**[12] Për këto dy vende do të flasim sërish më poshtë në vijim të këtij seksioni. T'i kthehemi këtu vendeve tipike evropiane të cilat modelohen sipas sistemit amerikan.

---

9 Michele Beletti, "Il sistema di giustizia costituzionale portoghese". Në Luca Mezeti (ed.), *SISTEMI E MODELLI DI GIUSTIZIA COSTITUZIONALE* (CEDAM: Padova, 2009) fq. 282-283; Për efektet praktike të vendimeve të Tribunal Constitucional në rastet e lëshimeve kushtetuese, cf. më shumë në: Joaquim de Sousa Ribeiro and Esperanca Mealha, "Constitutional Courts as Positive Legislators: Portugal". Në Allan R. Brewer – Caria, *Constitutional Courts as Positive Legislators. A Comparative Law Study* (Cambridge University Press: Cambridge, 2011) fq. 721- 733; Kurse për jo kushtetutshmërinë për shkak të lëshimit legjislativ në aspektin krahasimor, cf. kapitullin 4 ["CONSTITUTIONAL COURTS' INTERFERENCE WITH THE LEGISLATOR REGARDING LEGISLATIVE OMISSIONS] të librit voluminoz të Allan R. Brewer – Caria, *Constitutional Courts as Positive Legislators. A Comparative Law Study*, fq. 125-171.

10 **Greqia**, në fakt, nuk bën pjesë në kuptimin e ngushtë të fjalës në sistemin amerikan, por në sistemin e përzier. Kjo sepse në nenin 87.2 ["Funksionarët Gjyqësor dhe Stafi"] dhe nenin 93. 4 ["Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave'] të Kushtetutës së Greqisë gjenden urdhrat që në mënyrë të qartë urdhërojnë gjyqtarët grekë që mos të zbatojnë asnjë dispozitë që bie ndesh me Kushtetutën. Mirëpo, në nenin 100 (e) ["Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave"] të Kushtetutës flitet për kontrollin kushtetues të ligjeve si një e drejtë ekskluzive qe i takon vetëm gjykatës më të lartë të vendit, e cila quhet **Gjykata Speciale Supreme**. Pse? Kjo është kështu për shkak se, kjo Gjykatë, e cila themelohet sipas nenit 100 të Kushtetutës, cilësohet si një gjykatë **ad hoc**, jo e përhershme, dhe mblidhet vetëm për vendosjen e rasteve nga juridiksioni i saj i përcaktuar me nenin 100, ku bën pjesë edhe kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjeve. Gjykata përbëhet nga zyrtarët më të lartë të gjykatave të tjera dhe profesorët eminent të drejtësisë greke. Cilësimi si "Gjykatë Speciale Supreme" bëhet në literaturë juridike me qëllim të dallimit të saj nga dy gjykatat tjera që përcaktohen qartë me Kushtetutë: Gjykata Supreme Civile dhe Penale dhe Gjykata Supreme Administrative.
Finlanda, gjithashtu nuk bën pjesë në këtë sistem sepse atje ka një kontroll të kushtetutshmërisë që kryhet nga organet e specializuara brenda vetë ligjvënësit finlandez. Në fakt, ky vend, për dallim nga Greqia, përbën rastin e pastër evropian që nuk mund të kategorizohet në asnjërin prej tri sistemeve të gjyqësisë kushtetuese, ani se ka mekanizma për vlerësim të kushtetutshmërisë që janë të ankoruar në parlament dhe janë mjaft efektivë.

11 Në Britani, **Dhoma e Lordëve** ka një lloj të drejte për kontroll preventiv të legjislacionit britanik, por kjo nuk përbën kontroll të kushtetutshmërisë në kuptimin modern të kësaj fjalë, pra nuk përbën një mekanizëm që përdor një silogjizëm gjyqësor kundrejt një fakti kushtetues për të identifikuar kushtetutshmërinë e aktit legjislativ apo të aktit tjetër të ndonjë autoriteti publik. Përveç kësaj, ky organ nuk është specializuar për një gjë të tillë, siç është rasti me **Finlandën** dhe ligjvënësin e saj.

12 Në **Holandë,** Gjykata Supreme e ka të drejtën e vendosjes së rasteve që kanë të bëjnë me institucionet e Bashkimit Evropian.

Krahas vendeve skandinave, **Danimarkës**, **Norvegjisë,** dhe **Suedisë**, në sistemin amerikan të gjyqësisë kushtetuese në Evropë hyjnë edhe **Estonia** dhe **Irlanda**. **Greqia** është diskutuar në kapitullin pararendës. Të shohim si duket kjo në këto vende në rreshtat në vijim.

Në **Danimarkë**, kontrolli gjyqësor përfshin vlerësimin e legjitimitetit kushtetues të ligjeve dhe vlerësimin e legjitimitetit ligjor të akteve administrative. Si i tillë, kontrolli gjyqësor në këtë vend ka lindur si rezultat i praktikës gjyqësore, gjë që shihet nga K**ushtetuta e Danimarkës e vitit 1953**, aktualisht në fuqi, e cila nuk flet fare për mundësinë që gjykatat e rregullta të ushtrojnë kontrollin gjyqësor të legjitimitetit kushtetues të akteve ligjore e as për legjitimitetin ligjor të akteve administrative. Pjesa VI ["Gjykata e Lartë"] e Kushtetutës ka dy nene, nenin 59 ["Anëtarët e Gjykatës së Lartë"] dhe nenin 60 ["Kompetencat"], të cilat iu referohen anëtarëve dhe kompetencave të autoritetit më të lartë gjyqësor.

Neni në vijim i Kushtetutës, neni 61 ["Ushtrimi i Pushtetit Gjyqësor"], në mënyrë shprehimore përcakton se pushteti gjyqësor ushtrohet në bazë të ligjit. Ky urdhër kushtetues fuqizohet më tutje me nenin 64 ["Pavarësia e Gjyqtarëve"] të Kushtetutës, i cili vetëm ligjin e njeh si bazë për punën e pavarur të gjyqtarëve. Kjo nuk është kështu kur flitet për kontrollin e legjitimitetit ligjor të pushtetit ekzekutiv: në nenin 62 të pjesës së VI-të ["Ndarja e Pushteteve"] të Kushtetutës, fuqishëm theksohet pavarësia e gjyqësorit nga pushteti ekzekutiv, duke sanksionuar, në nenin 63 ["Kontrolli i Pushtetit Ekzekutiv"] të Kushtetutës, të drejtën absolute të gjyqësorit për të kontrolluar caqet e ushtrimit të pushtetit ekzekutiv përmes gjykatave administrative. Kjo e drejtë i takon në shkallë të fundit Gjykatës së Lartë, e cila e ruan të fjalën e fundit në kontrollin e ligjshmërisë së ushtrimit të pushtetit ekzekutiv.

Njëjtë si në rastin amerikan, modeli i **Danimarkës** ka lindur si pasojë e aktivizimit gjyqësor në kuadër të gjyqësorit të këtij vendi. Me këtë heshtazi janë pajtuar parlamenti dhe qeveria. Rasti i parë që ka nisur një lloj kontrolli gjyqësor të kushtetutshmërisë ka ndodhur më 1912, kur **Gjykata e Lartë (GJLD)** ka marrë të drejtën e vlerësimit të kushtetutshmërisë së ligjit që hiqte pagesën e të dhjetës. Me këtë rast, megjithatë, fjala ka qenë vetëm për një prononcim të saj, jo për deklarim të ligjit të kontestuar si jo kushtetues. Një gjë e tillë, pra kontrolli i legjitimitetit kushtetues të ligjit, ka ndodhur shumë më vonë, më 1971, kur **GJLD-ja** theksoi se nuk mund të ketë shpronësim pa kompensim të drejtë. Bëhej fjalë për një kontest konkret në mes të dy universiteteve të këtij vendi, ku njëri nga to synonte marrjen pa kompensim të kapitalit që posedonte tjetri.

Më vonë ka pasur edhe raste tjera të kësaj natyre. Më të rëndësishmet ndër to kanë ndodhur në fund të shekullit XX, kur **GJLD-ja** njohu interesin juridik të qytetarëve për të ushtruar padi kundër qeverisë së tyre lidhur me hyrjen e vendit në **Bashkimin Evropian**. Me këtë hap, **GJLD-ja** në njëfarë mënyre themeloi praktikën sipas së cilës rastet e mëdha dhe të ndjeshme, të cilat prekin interesat nacionale të të gjithë qytetarëve, mund të ngrihen pranë gjykatës së instancës së fundit në nivel nacional, pra jo pranë gjykatave të tjera të ulëta.

Edhe në **Danimarkë**, njëjtë si në sistemin amerikan, ligjet e shpallura si jo kushtetuese mbesin në fuqi në aspektin formal. Efektet e doktrinës **stare decisis**, megjithatë, nuk lejojnë që në praktikë të ndodhë një vendimmarrje e pakontrolluar dhe kontradiktore në nivele të gjykatave me kompetencë të njëjtë. Kjo do të thotë se ligjet e shpallura si jo kushtetuese ngelin pa asnjë efekt praktik përgjatë tërë kohës sa vlen precedenti i vendosur me vendimin gjyqësor me të cilin është shpallur si jo kushtetues ligjin i caktuar.

Ky model nuk është, duhet theksuar këtu, rezultat i supremacisë parlamentare. Kjo sepse pushteti legjislativ ndahet në mes të Parlamentit dhe Mbretit. Ky i fundit, në të njëjtën kohë, ushtron edhe pushtetin ekzekutiv përmes ministrave të tij. Kjo nënkupton se standardi i kontrollit të ligjshmërisë së veprimit administrativ të prerogativave mbretërore, siç janë veprimet e pastra politike në sfera të ndryshme, sipas nenit 63 të Kushtetutës nuk mund të jenë objekt i kontrollit gjyqësor. Në këtë grup të prerogativave mbretërore, të cilat nuk i nënshtrohen kontrollit gjyqësor, bëjnë pjesë, ta zëmë, kontrolli gjyqësor i mënyrës së ushtrimit të politikës së jashtme nga ana e mbretit dhe ministrit të tij të jashtëm.

Kontrolli gjyqësor i legjitimitetit të veprimit administrativ në **Danimarkë** më shumë ka të bëjë me sferën e taksave, shpronësimeve dhe kompensimeve për pronën etj.

Në **Norvegji**, kontrolli gjyqësor mund të jetë i dyllojtë: 1. kontrolli gjyqësor i kushtetutshmërisë së ligjeve me pikë referimi **Kushtetutën e Norvegjisë të vitit 1814** (me amendamentet e vitit 2014, të cilat shprehimisht flasin për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve); dhe, 2. kontrolli gjyqësor i ligjeve me pikë referimi **Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut** (**KEDNJ**).

Lloji i parë i kontrollit gjyqësor ka nisur në vitin 1866, me vendosjen e rastit të njohur **Wedel-Jarlsberg**, në ndërkohë që lloji i dytë i kontrollit gjyqësor nis më 1994, kur vendoset rasti **Bølgepapp**. Në rastin e parë të vitit 1866, fjala ka qenë për të drejtën e kompensimit të një oficeri të marinës norvegjeze, i cili nuk kompensohej për punën shtesë që kryente në marinë. Kjo u cilësua si antikushtetuese nga ana e **Gjykatës Supreme** (**GJSNo**), gjë që shënoi vendimin e parë themelues të kontrollit gjyqësor në **Norvegji**. Njëjtë si me rastin e **John Marshall**it në rastin **Marbury vs Madison** (1803), edhe këtu mbahet mend udhëzimi i **Peder Carl Lasson,** kryetarit të **GJSN-së**, për gjyqtarët e vendit, që rekomandonte fuqishëm që, nëse gjyqtarët hasin në dy ligje që duhen zbatuar, atëherë përparësi duhet t'i jepet ligjit më të lartë që quhet kushtetutë. Kjo e bën të qartë se në **Norvegji** që nga 1866 ka nisur ruajtja dhe sigurimi gjyqësor i supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës ndaj çdo akti tjetër juridik.

Rasti i dytë, ai i vitit 1994, shënon vendimin me të cilin kontrolli gjyqësor norvegjez bëhet jo vetëm ndaj kushtetutshmërisë së ligjeve nacionale, por edhe ndaj **KEDNJ-së**. Në këtë rast, **GJSN-ja** theksoi qartë se praktika gjyqësore në lëmin e të drejtave të njeriut në **Norvegji** mund të ndryshojë vetëm atëherë kur dispozitat e **KEDNJ-së** të jenë mjaftueshëm të qarta dhe pa dy kuptime. Kjo ndryshe quhet edhe **kontrolli i konvencionalitetit**, pra kontroll gjyqësor për të shikuar nëse ligjet e nxjerra bien ndesh me detyrimet ndërkombëtare të një vendi.

Këtu nuk flasim për kontrollin gjyqësor të veprimit administrativ në **Norvegji**. Ky kontroll rrallë herë ka karakter kushtetues: në parim, kontrolli i legjitimitetit ligjor të veprimit administrativ mbyllet në kuadër të gjykatave të instancave të ulëta, pa prodhuar ndonjë kontest kushtetues. Thënë shkurt, këtu flasim vetëm për kontrollin e legjitimitetit kushtetues të ligjeve që, historikisht shikuar, ka filluar duke u bazuar në sigurimin e supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës së vitit 1814, kurse më pastaj është zhvilluar edhe si kontroll i kushtetutshmërisë së ligjeve duke u bazuar në dispozitat e **KEDNJ-së**. Në këtë aspekt, pra në aspektin e dytë, **Kosova** nuk dallon shumë nga Norvegjia sepse kushtetutshmëria e ligjeve, akteve juridike dhe e veprimeve të tjera të autoriteteve publike vlerësohet duke marrë parasysh dispozitat e **KEDNJ-së**, të cilat janë pjesë e rendit kushtetues. Kjo buron nga neni 92 nën "E" ["Të Drejtat e Njeriut"] i Kushtetutës së Norvegjisë, i cili përcakton se "[...] Autoritetet e Shtetit respektojnë dhe sigurojnë të drejtat e njeriut siç janë të shkruara në Kushtetutë dhe në marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat janë të detyrueshme për Norvegjinë". Kësaj çështje i kthehemi në kapitullin 11-të, kur të flasim për **kontrollin e konvencionalitetit** në kontekstin e gjyqësisë kushtetuese kosovare.

Karakteristikat kryesore të sistemit norvegjez të kontrollit gjyqësor e bëjnë atë pjesë të sistemit amerikan të kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë. Secili gjyqtar ka të drejtë që të jetë gjyqtar kushtetues nëse gjatë vendosjes për një rast apo mosmarrëveshje kërkohet vlerësimi i kushtetutshmërisë së normës ligjore që duhet të zbatohet. Thënë ndryshe, fjala është për vendosje përmes rrugës së tërthortë (**incidenter**), jo përmes një rruge të centralizuar në një gjykatë të specializuar dhe të ndarë nga gjyqësori i rregullt. Kur ligji shpallet jo kushtetues atëherë ai mënjanohet, lihet anash. Kjo do të thotë se efektet e vendimit mbi jo kushtetutshmërinë kanë efekt **inter partes**. Mirëpo, në rastet kur vendimi ka karakterin e precedentit gjyqësor, efektet **stare decisis** e transformojnë këtë efekt në një efekt **erga omnes**, në veçanti kur ky precedent vendoset nga ana e **GJSNo**, e cila, sipas nenit 88 nën "D" ["Pushtetit Gjyqësor"] të Kushtetutës ka rolin kushtetues **nomofilatik** (unifikues i praktikës gjyqësore në nivel nacional). Bazuar në këtë nen, rastet e një rëndësie dhe kompleksiteti të veçantë vendosen nga ana e **GJSNo** si pjesë e unifikimit të praktikës gjyqësore në të gjitha fushat, përfshirë këtu edhe në çështjet kushtetuese. Kjo do të thotë se kontrolli kushtetues norvegjez është krijuar nga praktika

gjyqësore, njëjtë si në sistemin amerikan, për t'u sanksionuar më pastaj edhe formalisht me dispozita kushtetuese në vitin 2014.

Kushtetuta e Suedisë, njëjtë sikur ajo e Norvegjisë, kultivon dy lloje të kontrollit kushtetues të ligjeve: 1. kontrolli i legjitimitetit kushtetues të ligjeve bazuar në Kushtetutë; dhe 2. kontrolli i legjitimitetit kushtetues të ligjeve bazuar në **KEDNJ**. Me kushtetutë suedeze nënkuptohen katër akte juridike që janë nxjerrë ndër shekuj: 1. Ligji mbi Trashëgiminë (1810);[13] 2. Ligji mbi Lirinë e Shtypit (1949);[14] 3. Instrumenti i Qeverisjes (1974);[15] dhe 4. Ligji Fundamental mbi Lirinë e Shprehjes.[16] Të gjitha këto akte juridike janë ndryshuar dhe plotësuar nga koha kur janë nxjerrë.

Këtu flasim vetëm për kontrollin kushtetues të ligjeve, jo edhe për kontrollin kushtetues të akteve të tjera juridike apo të veprimit administrativ. Kjo për shkak se këto të fundit, në sistemin suedez, njëjtë si dhe në sistemin amerikan, nuk mund të përbëjnë një çështje kushtetuese në një mënyrë autonome: ato asnjëherë nuk arrijnë të bëhen të tilla pasi që zgjidhja e tyre ndodh në nivel të kontrollit të ligjshmërisë së veprimit administrativ shtetëror, pa prodhuar asnjëherë një çështje kushtetuese.

Në nenin 14 ["Kontrolli Gjyqësor"] të kapitullit 11 ["Administrimi i Drejtësisë"] të **Instrumentit të Qeverisjes**, urdhërohet që gjykatat mos t'i zbatojnë ligjet apo aktet e tjera juridike, të cilat bien në kundërshtim me Kushtetutën. Në po këtë nen në paragrafin e dytë, në mënyrë shprehëse nënvizohet autorizimi i gjykatave për të respektuar supremacinë e **Riksdag** (parlamentit suedez), por edhe supremacinë (epërsinë) e Kushtetutës, gjë që në terma praktikë do të thotë se vetëm bëhet mënjanimi i ligjit jo kushtetues, lënia e tij anash dhe moszbatimi i tij, por jo edhe heqja nga rendi kushtetues. Ky kontroll gjyqësor, siç mund të vërehet, është **a posteriori**, pra pasi që ligji ka hyrë në fuqi, si dhe bëhet përmes rrugës së tërthortë (**incidenter)**, si pjesë e vendimmarrjes së gjykatës në një rast apo mosmarrëveshje konkrete dhe, më në fund, kontrolli i tillë është i **decentralizuar**. Kjo do të ishte sa i përket kontrollit gjyqësor i cili autorizohet nga Kushtetuta.

Kontrolli gjyqësor i llojit të dytë, pra ai që derivohet nga **KEDNJ-ja,** përcaktohet me nenin 19 ["Konventa Evropiane"] të Kapitullit 2 ["Të Drejtat dhe Liritë Themelore"] të Instrumentit të Qeverisjes. Në këtë nen sanksionohet kontrolli preventiv i kushtetutshmërisë së ligjeve, pra kontrolli **a posteriori**, sepse urdhëron që të mos miratohet asnjëherë asnjë ligj apo akt tjetër juridik që bie ndesh me detyrimet e **Suedisë** sipas **KEDNJ-së**. Kjo është ngjashëm si në rastin norvegjez, pra fjala është për **kontrollin e konvencionalitetit**, një kontroll gjyqësor që kryhet me qëllim të shikimit nëse ligjet e nxjerra bien ndesh me detyrimet ndërkombëtare të një vendi. Në këtë aspekt, **Kosova** ka dispozita të ngjashme kushtetuese me **Norvegjinë**. Ato gjenden në nenin 113.3 (4) ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] të Kushtetutës së Kosovës, por vetëm sa i përket amendamenteve kushtetuese. Sipas kësaj dispozite kushtetuese, **Gjykata Kushtetuese** ka autorizim për **vlerësim të konvencionalitetit të amendamenteve të propozuara kushtetuese**, përkatësisht ka kompetencë për të vlerësuar përputhshmërinë e amendamenteve të propozuara kushtetuese me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare të ratifikuara sipas Kushtetutës. Ky autorizim kushtetues ekziston krahas autorizimit të **Gjykatës Kushtetuese** për të bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur për propozimin e amendamenteve kushtetuese.

---

13 Ligji mbi Trashëgiminë është nxjerrur më 1810 dhe është akoma në fuqi, me ndryshimet e vitit 1980, të cilat i japin të drejtën e trashëgimit të fronit mbretëror edhe femrave.

14 Ligji mbi Lirinë e Shtypit është nxjerrë më 1766 dhe është akoma në fuqi. Është ndryshuar disa herë, herën e fundit më 1991, për të akomoduar dhe normuar ndryshimet në teknikat dhe format e realizimit të lirisë kushtetuese për të shpërndarë informata në formë të shkruar në të gjitha format e saj.

15 Ligji mbi Lirinë e Shtypit është nxjerrë më 1766 dhe është akoma në fuqi. Është ndryshuar disa herë, herën e fundit më 1991, për të akomoduar dhe normuar ndryshimet në teknikat dhe format e realizimit të lirisë kushtetuese për të shpërndarë informata në formë të shkruar në të gjitha format e saj.

16 Ligji Fundamental mbi Lirinë e Shprehjes është nxjerrë më 1991 për herë të parë dhe akoma është në fuqi.

Me **Kushtetutën e Estonisë të vitit 1992**, ka nisur sistemi i kontrollit kushtetues: sipas nenit 149.2 ["Gjykatat"] të Kushtetutës, Gjykata Supreme (**GJSEst**) është gjykata më e lartë në vend me kompetencë të përgjithshme, për të ushtruar në të njëjtën kohë edhe kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjera juridike. Kjo reflektohet në faktin se brenda saj funksionon **Dhoma për Kontrollin e Kushtetutshmërisë**. Kjo dhomë kryesohet nga kryetari i **GJSEst** dhe përbëhet, së paku, edhe nga një anëtar prej secilës dhomë të saj (dhomës administrative, civile dhe penale). Anëtarët e **Dhomës Kushtetuese**, në të njëjtën kohë janë edhe anëtarë të **GJSEst**.

Neni 152.1 ["Gjykatat"] i Kushtetutës shprehimisht urdhëron gjykatat që, me rastin e vendosjes për një rast apo mosmarrëveshje në një procedurë gjyqësore, të mos zbatojnë asnjë ligj apo legjislacion tjetër që bie ndesh me të. Paragrafi në vijim i nenit të njëjtë, krejt natyrshëm ia njeh **GJSE-së** të drejtën ekskluzive të kontrollit përfundimtar kushtetues, sepse thekson se ajo mund të shpallë si të pavlefshëm çdo ligj apo legjislacion, i cili bie në konflikt me germën dhe frymën e Kushtetutës. Sikundër shihet, pra, sistemi estonez bazohet në rrugën e tërthortë (**incidenter**) dhe, në të njëjtën kohë, është një **sistem centralizuar** sepse vetëm **GJSEst** e ka të drejtën e kontrollit kushtetues të ligjeve dhe akteve të tjera juridike me forcë të përgjithshme detyruese (**erga omnes**) dhe në një mënyrë autoritative (përfundimtare). Gjykatat më të ulëta kanë vetëm të drejtën e moszbatimit të ligjeve që i konsiderojnë si jo kushtetuese, por nuk kanë të drejtën e interpretimit përfundimtar të kushtetutshmërisë së tyre.

Vendosja për çështjet kushtetuese kryhet nga një panel prej tre gjyqtarësh. Sipas rregullave të brendshme të **GJSEst**, megjithatë, ka mundësi që kontrolli i kushtetutshmërisë të ushtrohet nga përbërja e saj plenare. Kjo ndodh në këto raste: 1. kur rasti është referuar për zgjidhje nga Dhoma Kushtetuese; 2. kur rasti ka një rëndësi të veçantë kushtetuese; 3. kur rasti është ngritur nga ndonjëra prej tri dhomave tjera të **GJSEst**; 4. kur njëri nga gjyqtarët e Dhomës Kushtetuese ka mendim të kundërt; dhe, së fundi 5. kur **GJSEst** ka nevojë për të ndryshuar praktikën e mëparshme lidhur me ndonjë çështje.

Sa i përket palëve të autorizuara për t'u paraqitur në **GJSEst** me kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjera juridike, gjendja është si vijon:

- sipas nenit 107.2 ["Legjislacioni"] të Kushtetutës, në rast se **Riigikogu** (Parlamenti) miraton ligjin e kthyer nga Presidenti pa asnjë ndryshim, atëherë ky i fundit ka të drejtë ta referojë ligjin për kontroll kushtetues në Gjykatën Supreme;
- sipas nenit 15.2 ["["Të Drejtat Themelore, Liritë dhe Detyrat"] lidhur me nenin 152.2 ["Gjykatat"] të Kushtetutës, gjykatat e rregullta në të gjitha rastet kur nuk zbatojnë një ligj apo akt tjetër të përgjithshëm juridik sepse konsiderojnë se të njëjtat nuk janë në pajtim me Kushtetutën;
- sipas nenit 142 ["Avokati i Popullit"] të Kushtetutës, Avokati i Popullit, në rast se akti, ligji apo ndonjë akt tjetër i përgjithshëm juridik bie ndesh me Kushtetutën kurse organi që e ka nxjerrë aktin, ligjin apo aktin tjetër të përgjithshëm ka dështuar që t'i mënjanojë brenda njëzet ditësh anët e tyre kundërkushtetuese;
- sipas nenit 139.1 ["Avokati i Popullit"] të Kushtetutës, Avokati i Popullit ka të drejtën e të qenit palë edhe atëherë kur konsideron se një marrëveshje ndërkombëtare, e cila ratifikohet me ligj, por që akoma nuk ka hyrë në fuqi, bie ndesh me Kushtetutën;
- sipas nenit 15 ["Të Drejtat Themelore, Liritë dhe Detyrat"] të Kushtetutës, individët në të gjitha rastet para gjykatave të cilitdo nivel atëherë kur konsiderojnë se një ligj, akt juridik apo ndonjë procedurë cenon të drejtat dhe liritë e tyre të garantuara kushtetuese dhe nuk ka rrugë tjetër për mbrojtje juridike pos përmes shpalljes si jo kushtetuese të ligjeve apo akteve të tilla juridike dhe procedurave.

Sikundër mund të vërehet, kontrolli kushtetutës mund të ndiqet si përmes rrugës **ex ante** (para se ligji apo akti tjetër juridik të ketë hyrë në fuqi) ashtu edhe përmes rrugës **ex post** (pasi që ligji dhe akti tjetër juridik të ketë hyrë në fuqi).

Në **Irlandë** ekzistojnë dy lloje të kontrollit: kontrolli gjyqësor (judicial review) dhe kontrolli i kushtetutshmërisë (review of constitutionality). Në ndërkohë që i ky i fundit mandatohet me **Kushtetutën e Irlandës të vitit 1937**, aktualisht në fuqi, i pari ankorohet në praktikën e gjatë gjyqësore të këtij vendi dhe jo në ndonjë dispozitë konkrete kushtetuese. Këto dy lloje të kontrollit i japin këtij vendi vulën e sistemit amerikan, ani se kontrolli i kushtetutshmërisë ka lindur përmes përqafimit kushtetues në mënyrë shprehimore. I pari kontroll, ndërkaq, ka lindur si pasojë e ndikimit amerikan në sistemin kushtetues të këtij vendi.

Kontrolli gjyqësor ekziston si një e drejtë e secilit gjyqtar apo trup gjykues për të vënë mënjanë një ligj apo akt juridik që duhet të zbatohet në një rast apo mosmarrëveshje konkrete, u mor vesh, vetëm atëherë kur dyshojnë në kushtetutshmërinë e tyre. Kjo do të thotë se vendimi në një rast të tillë ka efekt **inter partes**. Kanë efekt të përgjithshëm detyrues (**erga omnes**) vetëm ato vendime të Gjykatës Supreme (**GJSIr**) të marra në vijim të ushtrimit të funksionit të saj nomoflikatik. Kjo vlen si për çështjet kushtetuese ashtu edhe për ato që nuk kanë natyrë të tillë: **stare decisis** i **GJSIr** përfundimisht stabilizon praktikën gjyqësore dhe iu jep fuqinë e normës precedentëve të ndërtuara nga ajo. Ky funksion unifikues i praktikës gjyqësore, **funksioni nomofilaktik**, sipas nenit 34. 4 (4 & 5) ["Gjykatat"] të Kushtetutës ushtrohet atëherë kur **GJSIr** vlerëson se çështja përbën një interes të theksuar publik apo kur bëhet fjalë për kënaqjen e interesave të drejtësisë. Në këto raste mund të vijë deri te kontrolli gjyqësor i kushtetutshmërisë përmes rrugës së tërthortë (**incidenter**).

Sa i përket kontrollit të kushtetutshmërisë përmes rrugës së drejtpërdrejtë, **Irlanda** ka dispozita kushtetuese që lejojnë një gjë të tillë, duke e paraqitur si palë të autorizuar Presidentin e Republikës. Sipas nenit 26.1 (1)["Legjislacioni"] të Kushtetutës, Presidenti, pas konsultimit me **Këshillin e Shtetit,** ka të drejtë që në **GJSIr** të referojë çdo ligj irlandez me qëllim të kontrollit preventiv të kushtetutshmërisë. Kjo është mënyrë e kontrollit të pastër abstrakt preventiv i kushtetutshmërisë, që kryhet nga **GJSIr** krahas kontrollit konkret në rrugët e tërthorta (**incidenter**) të kushtetutshmërisë.

Britania e Madhe dhe **Holanda**, siç u konstatua më sipër, nuk kanë fare sistem të kontrollit kushtetues, qoftë në kuptimin e ngushtë evropian/kelsenian apo në kuptimin e gjerë të vendeve tjera në të cilat ky kontroll ushtrohet nga organet tjera më të larta në kuadër të gjyqësorit të rregullt mirëpo duke zbatuar një procedurë speciale. Kjo nuk do të thotë, megjithatë, se në këto sisteme nuk ka mekanizma dhe instrumente tjerë që sigurojnë realizimin e misionit primar të gjyqësisë kushtetuese, i cili konsiston në sigurimin e supremacisë (epërsisë) dhe stabilitetit të Kushtetutës, ruajtjen e ndarjes dhe balansimit të pushteteve, si dhe garantimin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive kushtetuese. Me kushtetutë, u mor vesh, këtu nuk duhet kuptuar vetëm tekstin e shkruar por krejt rregullativën e shkruar dhe të pashkruar, siç janë, ta zëmë, zakonet apo konventat e ndryshme në Britaninë e Madhe, të cilat përcaktojnë rregullat mbi origjinën, formimin, organizimin dhe ushtrimin e pushtetit politik dhe rolin e individit në shoqëri.

Në Britaninë e Madhe, më 2005, është krijuar një **Gjykatë Supreme**, si një hap i natyrshëm pas miratimit më 1998 të **Human Rights Act** (**Ligji mbi të Drejtat e Njeriut**). Ky ligj i detyron gjykatat vendore britanike që të kenë kujdes për mbrojtjen dhe sigurimin e lirive dhe të drejtave të garantuara me të. Kjo rrethanë, megjithatë, nuk ndryshon konstatimin tonë si më sipër se Britania nuk ka kontroll kushtetues të ligjeve dhe akteve tjera juridike të autoriteteve publike në kuptimin që ne flasim në këtë libër. Parlamenti i Britanisë së Madhe sërish ruan supremacinë (epërsinë) e vet të pakontestueshme, kurse gjykatat bëjnë interpretimin dogmatik të vullnetit të tij pa pasur ndonjë liri të madhe kreative në biznesin e interpretimit. Nxjerrja e **Human Rights Act** (**Ligjit për të Drejtat e Njeriut**) ka qenë rezultat i kritikave të mëdha ndaj moszbatimit si duhet të vendimeve të **Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut** (**GJEDNJ**), gjë që e bënte këtë vend të humbë në reputacion në nivel evropian. Ky moszbatim vinte si pasojë e

botëkuptimeve dhe praktikave krejtësisht të ndryshme britanike sa i përket standardeve mbi liritë dhe të drejtat e njeriut krahasuar me ato të njohura nga **KEDNJ-ja**, e cila kishte standarde më të larta në lëmin e lirive dhe të drejtave të njeriut. Dalja e Britanisë së Madhe nga Bashkimi Evropian më 23 qershor 2016, tanimë e njohur si **BREXIT**, vërteton katërçipërisht se supremacia (epërsia) e parlamentit është thellë e rrënjosur në vetëdijen britanike dhe në strukturat e institucionet e sistemit kushtetues britanik ashtu që vështirë të pritet se kjo gjendje mund të ndryshojë dukshëm ndonjëherë.

Holanda, ndërkaq, për dallim nga Britania e Madhe, ka një kushtetutë të shkruar – Kushtetutën e vitit 1815, aktualisht në fuqi. Sipas një tradite të gjatë prej më se dy shekujsh, Kushtetuta ka themeluar mekanizma të tjerë përmes të cilave arrihet sigurimi i supremacisë (epërsisë) së saj me efekt të njëjtë që shkaktohet nga institucioni i gjyqësisë kushtetuese në vendet tjera në dy anët e Atlantikut. Këto mekanizma, njëjtë si në Britaninë e Madhe, kanë të bëjnë me mekanizmat kushtetues që garantojnë ndarjen dhe balancimin e pushteteve, sundimin e ligjit, respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Kjo e fundit është theksuar në veçanti në kapitullin e parë të Kushtetutës, e cila në tërësi i kushtohet të drejtave dhe lirive njerëzore. Për më tepër, vlen të theksohet këtu edhe një specifikë tjetër e veçantë e Holandës: ky vend është ndër të rrallët në Evropë dhe në botë që përqafon supremacinë (epërsinë) e të drejtës së përgjithshme ndërkombëtare ndaj rendit objektiv të përcaktuar me kushtetutë (**monizmi**).[17]

Kushtetuta e vitit 1815, është ndryshuar disa herë në mënyrë rrënjësore: ndryshimi i parë rrënjësor ka ndodhur më 1848, kur është futur sistemi i demokracisë parlamentare në dritën e lëvizjeve revolucionare në Evropën e asaj kohe. Herën e dytë ndryshimet e thella kushtetuese janë kryer më 1983, duke futur një sistem të të drejtave dhe lirive njerëzore mjaft të dendur.

Kushtetuta sanksionon supremacinë (epërsinë) absolute të parlamentit. Kjo do të thotë se asnjë gjykatë në **Holandë** nuk mund të testojë vlefshmërinë e legjitimitetit kushtetues të legjslacionit të miratuar nga parlamenti. Kjo qartë thuhet në nenin 120 të kapitullit 6-të ["Administrimi i Drejtësisë] të Kushtetutës, i cili konstaton se gjykatat nuk mund të bëjnë kontrollin kushtetues të akteve të Parlamentit dhe as kontrollin kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Njëjtë si në Britaninë e Madhe, ku Gjykata Supreme dhe gjykatat e rregullta duhet të kenë parasysh vënien në jetë të standardeve evropiane mbi të drejtat dhe liritë njerëzore, në veçanti ato që janë të njohura në **KEDNJ**, edhe në **Holandë** gjyqësori i rregullt mund të bëjë kontrollin kushtetues të ligjeve duke iu referuar dispozitave evropiane dhe ndërkombëtare mbi të drejtat dhe liritë e njeriut. Kjo mundësi parashihet në nenet 93[18] dhe 94[19] të **Kushtetutës së Holandës**.

Sa i përket mekanizmave institucionalë të kontrollit kushtetues, në **Holandë** ata janë të natyrës politike, pra ekzistojnë jashtë gjyqësorit. Kjo është rezultat i drejtpërdrejtë i formulimit të nenit 120 të Kushtetutës, i cili i citua më sipër. Këtë rol e luajnë dy organe kushtetuese: 1. **Këshilli i Shtetit** (**Raad van State**), një këshilltar i pavarur i Qeverisë dhe Parlamentit; dhe 2. **Senati i Holandës**, si përgjegjësi kryesor për cilësinë e ligjeve të këtij vendi.

---

17 Kjo qartë shprehet në mënyrë krejt specifike në nenin 90 të kapitullit të 5-të ["Legjislacioni dhe Administrata"] të Kushtetutës ku theksohet se qeverisja në Holandë promovon zhvillimin e sundimit ndërkombëtar të ligjit. Dy nenet tjera në vijim, nenet 91 dhe 92, të cilat flasin për marrëveshjet ndërkombëtare dhe për bartjen e pushtetit shtetëror (legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor) në institucionet ndërkombëtare, elaborojnë monizmin holandez deri në detaje dhe në mënyrë të rrallë për standardet kushtetuese perëndimore.

18 Neni 93 i kapitullit të 5-të ["Legjislacioni dhe Administrata"] të Kushtetutës: "Dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe rezolutave të institucioneve ndërkombëtare që mund të jenë të detyrueshme ndaj të gjithëve si pasojë e përmbajtjes së tyre, do të jenë të detyrueshme pasi të jenë publikuar".

19 Neni 94 i kapitullit të 5-të ["Legjislacioni dhe Administrata"] të Kushtetutës: "Dispozitat ligjore në fuqi brenda Mbretërisë nuk do të zbatohen nëse zbatimi i tyre bie ndesh me dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe rezultateve të institucioneve ndërkombëtare që janë të detyrueshme ndaj të gjithëve".

4.5. Komente dhe pyetje

4.5.1. Kontrolli gjyqësor në **SHBA** ka pasur një rrugë tjetër zhvillimore, e cila ka shkaktuar lindjen e një fizionomie të re të këtij instituti kaq me rëndësi për zhvillimin e konstitucionalizmit perëndimor. Kjo rrugë amerikane ka dalluar në thelb nga ajo britanike dhe është bazuar në botëkuptime krejtësisht të ndryshme lidhur me origjinën dhe natyrën e pushtetit: deri sa në Britani pushteti, deri në **Revolucionin e Famshëm** (1699), shihej si hyjnor dhe të drejtat natyrore thuajse në tërësi identifikoheshin më të drejtat hyjnore dhe interpretimin e tyre teologjik, në **SHBA** idetë e **Xhon Lokut** mbi të drejtat njerëzore si të drejta të patjetërsueshme dhe natyrore i jepnin domosdo pushtetit një natyrë krejtësisht njerëzore, natyrë që mund të kufizohej vetëm përmes një marrëveshjeje të re sociale në mes të vetë njerëzve. Në rastin britanik, rrënjët hyjnore të pushtetit vetë u "çrrënjosën", aq sa për t'u "rimbjellë" sërish pas vitit 1688 në parlament. Në anën tjetër të Atlantikut këto rrënjë u kërkuan në vetë popullin amerikan. Si u përkthyen këto dallime konceptuale lidhur me origjinën dhe fizionominë e pushtetit dhe të drejtave të njeriut në SHBA pas fitimit të pavarësisë më 1776 dhe cilit organ iu njoh e drejta për të siguruar supremacinë (epërsinë) e kushtetutës? Çfarë thonë për këtë **Letrat e Federalistit** (**Federalist Papers: 1787 - 1788**)?

4.5.2. Kompetenca e **GJSSHBA** për të ushtruar kontrollin e kushtetutshmërisë në SHBA, tanimë u konstatua: ajo buron nga doktrina e autorëve të **Letrat e Federalistit** (**Federalist Papers**) dhe e Gjykatës Supreme. Duke përdorur formulimin kushtetues sipas të cilit objekt i vendimmarrjes në Gjykatës Supreme është çdo "rast dhe mosmarrëveshje", Kushtetuta në mënyrë shprehimore ia ka mohuar asaj të drejtën për dhënien e mendimeve këshillëdhënëse.

Nga shtjellimi i **GJSSHBA** në lidhje me garantimin (ruajtjen) e supremacisë (epërsisë) të Kushtetutës së SHBA-së në nivel nacional kanë buruar edhe tri konsekuenca tjera: **e para** ka të bëjë me raportin e **GJSSHBA** me vendimet e gjykatave supreme të shteteve anëtare; **e dyta** konsekuencë lidhet me raportin e ligjvënësit në nivel shteti kundrejt Kushtetutës dhe ligjvënësit në nivel federal (Kongresit të SHBA-së); dhe, së fundi, konsekuenca **e tretë** i referohet raportit në nivel vertikal të ekzekutivit dhe administratës amerikane kundrejt ekzekutivit dhe administratës në nivel të shteteve anëtare. Çka do të thotë kjo?

4.5.3. Neni III i Kushtetutës së **SHBA**-ve flet për juridiksionin e **GJSSHBA**, kurse neni VI rregullon detyrimin e gjyqtarëve të shteteve anëtare për të siguruar supremacinë (epërsinë) e Kushtetutës në çështjet në të cilat gjykatat shtetërore kanë juridiksion origjinal. Në çështjet kushtetuese, sipas një interpretimi të Gjykatës Supreme, këto dy nene lejonin mundësinë që të ketë dyshkallëshmëri. Çfarë do të thotë kjo?

4.5.4. Në fillim ka pasur propozime që sistemi i ri kushtetues amerikan të mbështetej në një institucion tjetër jashtë gjyqësorit amerikan, por me funksion të njëjtë - ruajtjen e supremacisë (epërsisë) së kushtetues. Kjo, megjithatë, nuk u pranua. Për çfarë bëhet fjalë këtu?

4.5.5. Cilat janë dy cilësi themelore që e dallojnë sistemin amerikan të kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë nga **sistemi evropian/kelsenian**?

4.5.6. Deri më 1988, çdo çështje kushtetuese e vendosur në nivel të gjykatave të ulëta federale, si dhe ne nivel të gjykatave të tjera të ulëta në nivel shteti, kalonin për vendosje në Gjykatën Supreme. Tani kjo praktikë ka ndryshuar: gjendet në diskrecion të **GJSSHBA** për të vendosur se cilat çështje kushtetuese do të vendosen në mënyrë përfundimtare nga ana e saj. Si quhet ky diskrecion? Zakonisht, në cilat raste në praktikë është ushtruar ky diskrecion nga ana e **GJSSHBA**?

4.5.7. Sistemi **evropian/kelsenian** i gjyqësisë kushtetuese zakonisht identifikohet me ekzistimin e gjykatave të ndara kushtetuese, si gjykata të specializuara në lëmin e gjyqësisë kushtetuese. Kjo, megjithatë, nuk është kështu sepse ka disa cilësi tjera që janë përcaktuese të këtij sistemi. Cilat janë ato cilësi dalluese të këtij sistemi krahasuar me sistemin amerikan dhe me sistemet tjera të gjyqësisë kushtetuese?

4.5.8. Sistemi i përzier i gjyqësisë kushtetuese, në **Evropë** ekziston vetëm në një vend. Cili është ai vend dhe cilat janë cilësitë dalluese të sistemit të përzier të gjyqësisë kushtetuese?

4.5.9. Në arsyetimin shmitian, shefi i shtetit del si ruajtës i kushtetutës për shkak se paraqet simbolin e vullnetit unik politik dhe konkret të popullit. Ky vullnet paraqet në të njëjtën kohë kushtetutën, gardian i së cilës është shefi i shtetit si përfaqësues i vullnetit sublim të krejt popullit. Në rastin portugez, ndërkaq, shefi i shtetit paraqitet si gardian i kushtetutës, mirëpo jo për arsye se paraqet vullnetin sublim të krejt popullit portugez. Cilat janë arsyet që Kushtetuta e vitit 1976, ia njeh shefit të shtetit autorizimin e gardianit të kushtetutës?

4.5.10. Aktualisht, në Portugali ekzistojnë katër lloje të kontrollit kushtetues: 1. **kontrolli kushtetues preventiv**; 2. **kontrolli kushtetues abstrakt a posteriori**; 3. **kontrolli kushtetues konkret a posteriori**; dhe 4. **kontrolli kushtetues për lëshim (mosveprim).** çfarë kuptimi kanë secili prej tyre, çka dallojnë ndërmjet vete?

4.5.11. Në **Portugali** kontrolli kushtetues përmes rrugës së tërthortë, **incidenter**, është mjaft i përhapur dhe bën pjesë në cilësitë dalluese të gjyqësisë kushtetuese të këtij vendi. Çfarë mund të jetë objekt i kontrollit incidenter sipas Kushtetutës së Portugalisë? Me një fjalë, cilat lloje të normave juridike të këtij vendi mund të jenë objekt i kontrollit kushtetues incidenter?

4.5.12. Kontrolli i llojit të katërt dhe i fundit, **kontrolli kushtetues për lëshim (mosveprim),** në **Portugali** përbën, në aspektin material, një vijë të hollë dhe vështirë të dallueshme në mes të kontrollit politik dhe jo politik të kushtetutshmërisë. Në çka konsiston kontrolli kushtetues për lëshim (mosveprim) dhe cila është natyra juridike e verdiktit të **TKPo** të lëshuar në rastet e lëshimit (mosveprimit) kushtetutës të kryer nga ana e organit legjislativ në nivel nacional?

4.5.13. **Norvegjia**, njëjtë si shumica e vendeve skandinave, kontrollin gjyqësor të kushtetutshmërisë e ka nisur si pasojë e aktivizimit gjyqësor të instancës më të lartë të këtij vendi. Kur daton vendimi i parë i **GJSNo** dhe në çfarë mënyre precedenti norvegjez ngjason me atë amerikan?

4.5.14. Sado që **Norvegjia** bën pjesë në sistemin amerikan të kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë, megjithatë ka një praktikë të përbashkët me Kosovën në lëmin e gjyqësisë kushtetuese. Në çka konsiston kjo ngjashmëri e Kosovës me Norvegjinë në lëmin e gjyqësisë kushtetuese?

4.5.15. Suedia ka dy lloje të kontrollit kushtetues: njëri bazohet në kushtetutë, kurse tjetri në **KEDN**. Çfarë kuptimi ka njëri kontroll e çfarë tjetri dhe çfarë cilësish ka kontrolli i autorizuar me kushtetutë?

4.5.16. Lloji i dytë i kontrollit kushtetues, i njohur si kontrolli i konvencionalitetit, ekziston edhe në vendet tjera skandinave, jo vetëm në **Suedi**. Në këtë aspekt, Kushtetuta e Kosovës ka dispozita të ngjashme kushtetuese, por jo sa i përket kontrollit të konvencionalitetit të ligjeve. Tregoni se për çfarë **kontrolli të konvencionalitetit** flasin dispozitat kushtetuese kosovare dhe si ngjajnë ato me zgjidhjet kushtetuese të vendeve skandinave sa i përket kontrollit të konvencionalitetit?

4.5.17. Në **Estoni**, kontrolli i kushtetutshmërisë është futur me Kushtetutën e vitit 1992 të këtij vendi. Ky kontroll bën pjesë në sistemin amerikan të kontrollit të kushtetutshmërisë, por me disa dallime të theksuara. Estonia llogaritet në sistemin amerikan sepse nuk ka një gjykatë të ndarë kushtetuese: gjykatat e rregullta kanë detyrim kushtetues që të mos zbatojnë asnjë normë ligjore apo ndonjë normë tjetër me karakter të përgjithshëm apo të veçantë që bien ndesh me Kushtetutën e vendit. Këtu ndërpritet ngjashmëria me sistemin amerikan. Tregoni se cilat janë cilësitë themelore të kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë në Estoni, si në aspektin e zgjidhjeve institucionale ashtu dhe për sa i përket palëve të autorizuara për t'i vënë në lëvizje procedurat e kontrollit kushtetues?

4.5.18. Në **Irlandë** ekzistojnë dy lloje të kontrollit. Cilat janë ato?

4.5.19. Kontrolli abstrakt ekziston në **Irlandë**, por vetëm në një formë të kufizuar: ai është kontroll abstrakt preventiv dhe mund të iniciohet vetëm nga Presidenti i Republikës. A është kjo kështu?

4.5.20. Britania e Madhe dhe **Holanda** nuk kanë fare sistem të kontrollit kushtetues, qoftë në kuptimin

e ngushtë apo në kuptimin e gjerë **evropian/kelsenian**, pra qoftë në kuptim të vendeve që kanë gjykata të ndara kushtetuese ose të vendeve tjera në të cilat kontrolli kushtetutshmërisë ushtrohet nga gjykatat më të larta brenda sistemit të gjyqësisë së rregullt, mirëpo duke e zbatuar një procedurë speciale. Kjo nuk do të thotë, megjithatë, se në këto dy vende nuk ekzistojnë mekanizma dhe instrumente tjera që sigurojnë realizimin e misionit primar të gjyqësisë kushtetuese, mision që konsiston në sigurimin e supremacisë (epërsisë) dhe stabilitetit kushtetutës, ruajtjen e ndarjes dhe balansimit të pushteteve dhe garantimin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive kushtetuese. Çfarë do të thotë kjo? Shpjegoni si vihet në jetë konstitucionalizmi në këto dy vende në të cilat nuk ekziston një mekanizëm institucional apo një procedurë që ka fizionominë e gjyqësisë kushtetuese?

4.6. Lexim shtesë

- John E. Ferejohn, "Constitutuional Review in the Global Context" *New York University Journal of Legislation & Public Policy* Vol. 6 Issue 1 (2002);
- Victor Ferreres Comella, "The European model of constitutional review of legilsation: Toward decentralisation". *International Journal of Constitutional Law* Vol. 2 No. 2 (2004);
- Schnutz Rudolf Durr, "Comparative Overview of European Systems of Constitutional Justice". *Vienna Journal on International Constitutional Law* Vol. 5 Issue 2 (2011);
- Jurgen C.A. de Poorter, "Constitutional Review in the Netherlands: A Joint Responsibility". *Utrecht Law Review* Vol. 9 No. 2 (March) 2013;
- Leonard F.M. Besselink, The Proliferation of Constitutional Law and Constitutional Adjudication, or How American Judicial Review Came to Europe After All". Utrecht Law Review Vol. 9 Issue 2 (March 2013);
- Arne Marjan Mavčič (ed.), *Constitutional Review Systems Around the World* (Vandeplas Publishing: USA, 2018.

5. SISTEMET (II): VENDET ISH-KOMUNISTE, DJE DHE SOT

Përgjithësisht. - Në vendet ish-komuniste, mosekzistimi i gjyqësisë kushtetuese në literaturë është shpjeguar me natyrën e pushtetit si dhe të organeve që kanë qenë bartës të atij pushteti në këto vende. Sa i përket cilësisë së parë, ai pushtet është konsideruar unik dhe i pandarë që i ka takuar vetëm një shtrese sociale, klasës punëtore apo proletariatit. Shtresat tjera shoqërore, siç janë intelektualët, bujqit, zejtarët dhe të tjerët më pak janë përmendur në përbërësit e pushtetit në vendet ish-komuniste. Ish-**Jugosllavia** mbase përbën një përjashtim: pas vitit 1950, me futjen e vetëqeverisjes së sistemin kushtetues, u përdorën termat më gjithëpërfshirës, siç janë qytetarët dhe populli punues, që përfshinte praktikisht të gjitha shtresat si pjesëmarrëse në ushtrimin e pushtetit socialist. Në këto vende, sovraniteti konsiderohej si diçka që ka ngjyrë socialiste dhe ideologjike, pra komuniste, siç ishte edhe vetë pushteti në këto vende, si një pushtet unik dhe i pandarë. Ky pushtet, sipas teorisë dhe praktikës së vendeve socialiste, ushtrohej nga kuvendi si organ më i lartë përfaqësues i atyre që cilësoheshin si subjekte përbërëse të atij pushteti. Kjo ka qenë cilësi e të gjitha vendeve ish-komuniste, me përjashtim të ish-**Jugosllavisë**, e cila, siç u tha, pas futjes së sistemit vetëqeverisës, futi në përdorim disa koncepte tjera mbi vendndodhjen e pushtetit, siç ishin këshillat punëtore, organizatat e punës së bashkuar, si dhe format tjera të organizimit vetëqeverisës. Për ish-**Jugosllavinë** flasim në vijim të këtij seksioni. Këtu mjafton të theksohet se, pa marrë parasysh këtë dallim formal sa i përket organeve të ndryshme ku supozohet që ekzistonte pushteti në vendet ish-komuniste, përfshirë ish-**Jugosllavinë**, pushteti i vërtetë qëndronte në Partinë Komuniste, si një avangardë, e cila kishte rol të garantuar kushtetues për të kontrolluar të gjitha levat e pushtetit unik dhe të pandarë. Këtë e ka shprehur më së miri në mënyrë letrare nobelisti amerikan me origjinë polake, shkrimtari i njohur disident ***Çasllav Millosh*** (Czeslaw Milosz :1911-2004), kur ka shkruar për qytetarin e vendeve ish-komuniste se "[…] i mësuar të jetojë në një sistem ku nuk ekziston e drejta, ku ligji nuk është veçse një vegël në duart e Partisë… ai kurrsesi nuk mund të konceptojë një regjim ku çdo qytetar, i rëndomtë apo i pushtetshëm, ndjehet i lidhur nga sa parashikohet në dispozitat ligjore".[1]

Këto dy cilësi si më sipër, pra natyra e pushtetit dhe e vetë organeve që e kanë ushtruar atë pushtet, kanë përcaktuar edhe sistemin e kontrollit të kushtetutshmërisë. Ai kontroll ka qenë jashtëgjyqësor dhe politik. Cilësia e parë do të thotë se asnjë organ gjyqësor i asnjë niveli nuk ka pasur të drejtë që ta vë në diskutim apo ta kontestojë kushtetutshmërinë e ndonjë ligji të nxjerrë nga organi përfaqësues i pushtetit unik socialist. Cilësia e dytë është se organi që ka ushtruar kontrollin kushtetues të ligjeve ka qenë organi politik si në formë ashtu dhe në përmbajtje. Në formë, sepse organi përfaqësues ka kryer sipas kushtetutës çdo kontroll të kushtetutshmërisë së ligjeve, duke përjashtuar organet tjera të pushtetit shtetëror nga ky proces. Në përmbajtje, sepse organi përfaqësues ka punuar sipas urdhrave dhe direktivave të partisë së vetme të garantuar me kushtetutë nacionale si parti me të drejtën e monopolit për pushtet, partisë komuniste. Përveç këtyre dy aspekteve, në literaturë është vërejtur edhe një rrethanë tjetër që ka kushtëzuar këtë lloj të kontrollit kushtetues, pra të kontrollit politik dhe jashtëgjyqësor të kontrollit kushtetues në vendet ish-komuniste. Kjo rrethanë ka të bëjë me cilësinë elastike të kushtetutave të ish vendeve komuniste, pra si kushtetuta që kanë mundur të

[1] Czeslaw Milossz, *Mendja e robëruar. Ese mbi logogracitë popullore* (Pika pa sipërfaqe: Tiranë, 2019) fq. 60 (ky libër është botuar në vitin 1953, në kulmin e **Luftës së Ftohtë** dhe ka qenë i ndaluar në vendet ish-komuniste sepse demaskonte në tërësi doktrinën dhe praktikën komuniste të skllavërimit të njeriut dhe të popujve, duke shkaktuar degjenerimin e sistemeve socio-politike, të artit e letërsisë dhe të çdo forme tjetër të krijimtarisë njerëzore me qëllim të përshtatjes së tyre interesave të **Partisë Komuniste**).

ndryshohen fare lehtë dhe sipas procedurave krejtësisht të kalueshme për amendamentim të tekstit të kushtetutës. Kjo rrethanë, me shumë të drejtë, në literaturë shpjegohet me dy cilësitë e më sipërme që kanë të bëjnë me natyrën e pushtetit dhe bartësin e atij në vendet ish-komuniste: këto organe, si bartëse ekskluzive të pushtetit unik dhe të pandarë janë organe përfaqësuese dhe bartëse të vetme të konstitucionalizmit socialist.[2] Ky lloj konstitucionalizmit socialist nënkupton që organi që është bartës i pushtetit unik dhe të pandarë socialist vetëpërcakton edhe kushtetutshmërinë e tyre para se ato të marrin aprovimin nga vetë ai organ. Në praktikë, një gjë e tillë ka nënkuptuar se çdo ligj dhe normë tjetër juridike më e lartë apo më e ulët se kushtetuta duhet të jetë në përputhje me natyrën unike të pushtetit dhe cilësinë e tij ideologjike, pra në pajtim me ideologjinë komuniste, pushtet ky që ushtrohej në emër të subjekteve të ideologjizuara sipas vetë kushtetutës dhe ligjeve. Ky ideologjizim i takonte organizatës politike avangarde që kishte monopol në ushtrimin e pushtetit politik dhe që paraqiste partinë e vetme politike. Fjalën e kemi për Partinë Komuniste e cila ishte e vetmja që me kushtetutë e kishte të garantuar monopolin në ushtrimin e pushtetit në çdo nivel: edhe në ato pak raste ku kanë ekzistuar edhe partitë tjera politike, ato kanë qenë vetëm fiktive dhe pa asnjë ndikim sepse partia komuniste ka qenë ajo që ka pasur monopol absolut në ushtrimin e pushtetit politik në vend.

Përjashtim nga vendet ish-komuniste që kanë pasur kontroll kushtetues politik dhe jashtëgjyqësor, janë ish-Jugosllavia, Çekosllovakia dhe **Polonia**. Së bashku me këto dy të fundit diskutojmë rastin e **Hungarisë**, si më specifik në aspekt të gjyqësisë kushtetuese. Pas këtij seksioni diskutohen vendet tjera ish-komuniste, të cilat kryesisht kanë qenë nën orbitën politike dhe ushtarake të ish-BRSS dhe të cilat historikisht janë modeluar sipas sistemit politik dhe kushtetues sovjetik, përkatësisht rus.

5.1. Jugosllavia

Rasti i ish-**Jugosllavisë** ka rëndësi në lëmin e gjyqësisë kushtetuese për dy arsye: ***e para,*** sepse ka qenë vendi i parë komunist që ka futur në përdorim gjyqësinë kushtetuese dhe, ***e dyta,*** sepse gjatë kohës së **Luftës së Ftohtë** në mesin e shkencëtarëve perëndimorë ka shërbyer si konfirmim i idesë se institucioni i gjyqësisë kushtetuese jo domosdo është i papajtueshëm me parimet dhe vlerat e sistemeve jodemokratike kushtetuese që në atë kohë ekzistonin dhe që bazoheshin në unitetin e pushtetit, mosrespektimin e të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve, në arbitraritetin gjatë ushtrimit të pushtetit, mossundimin e ligjit dhe kështu me radhë. Në rastin jugosllav, si dhe në rastin polak dhe çekosllovak pak vite më vonë, u pa qartë se konstitucionalizmi bashkëkohor i ka dy forma, liberale dhe jo liberale, por që në secilin rast ai bazohet në sigurimin e supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës dhe rendit objektiv që bazohet në të, pa marrë parasysh nëse ai rend është liberal apo i bazuar në postulatet e diktaturës së proletariatit apo të ndonjë sistemi tjetër jodemokratik (siç janë aktualisht disa vende arabe apo islamike, si dhe disa vende tjera si **Venezuela**, **Kuba** etj.). Esenca e gjyqësisë kushtetuese, në fakt, konsiston në ruajtjen dhe sigurimin e supremacisë (epërsisë) së rendit objektiv kushtetues, krahasuar me çdo rend tjetër që mund të ekzistojë në kuadër të rendit të njëjtë objektiv kushtetues. Këtë e kemi konstatuar kur kemi folur për lindjen e gjyqësisë kushtetuese dhe arsyet e lindjes së saj përgjatë historisë. Kjo esencë ka ekzistuar edhe në rastin e vendeve ish-komuniste, të cilat kanë pasur gjyqësi kushtetuese të modeluar sipas modelit **kelzenian/evropian**. I tillë ka qenë rasti me ish-Jugosllavinë, më vonë deri diku edhe me Çekosllovakinë dhe **Poloninë.**

E nisur më 1963, si në nivel federal ashtu dhe në nivel të republikave përbërëse të unionit, gjyqësia kushtetuese jugosllave, si e para ndër vendet ish-komuniste, ka qenë e katërta gjykatë kushtetuese në Evropë e modeluar sipas sistemit **kelsenian/evropian**.[3] Ajo ka luajtur një rol të spikatur në sigurimin, mbrojtjen dhe promovimin e supremacisë (epërsisë) së rendit kushtetues komunist jugosllav. Ai

---

2 Dr. Jovan Gjorgjeviq*, E DREJTA KUSHTETUESE* (Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës: Prishtinë, 1972) fq. 764.

3 Bosa Nenadić, "UVODNE NAPOMENE". Në Bosa Nenadic (ed.), *USTAVNI SUD REPUBLIKE SRBIJE 1963-2008* (Službeni glasnik: Beogrda, 2009) (vetëm në alfabetin cirilik, në gjuhën serbe) fq. 9.

rend kushtetues, njëjtë si në ish vendet komuniste, bazohej në parimin e unitetit të pushtetit socialist, solidaritetin e klasës punëtore dhe solidaritetin komunist, pronën shoqërore dhe të drejtat e njeriut të garantuara me kushtetutë, **por të cilat me ligj mund të kufizoheshin në çdo kohë, kur këtë e kërkonte interesi i lartë për ndërtimin e socializmit**.[4] Përveç këtyre, ai rend kushtetues nuk bazohej në sundimin e ligjit, por në diktaturën e proletariatit si kategori e mbrojtur kushtetuese, diktaturë që ushtrohej në emër të klasës punëtore nga ana e Partisë Komuniste Jugosllave si një avangardë, prijatare apo udhëheqëse, e klasës punëtore jugosllave. As që mund të flitej për pluralizëm të ideve dhe mendimeve politike si një kusht thelbësor për formimin e ligjeve, të cilat çdoherë duhet të reflektojnë sa më shumë që të jetë e mundur çdo dallim apo kundërthënie socio-politike, ekonomike, kulturore dhe tjetër në një shoqëri të organizuar në shtet.[5]

Kushtetutshmëria, e cila vlerësohej nga **Gjykata Kushtetuese e RSFJ (GJKRSFJ)**, si dhe nga gjykatat kushtetuese republikane dhe, më vonë, ato krahinore (**Kosova** dhe **Vojvodina**) me fillim nga vitet ’70 të shekullit të kaluar, ka qenë e thjeshtë dhe dogmatike deri në fund. Para se të shohim nga afër se si ka funksionuar kjo në atë kohë, vlen të theksohet këtu se para vitit 1963, kontrolli kushtetues jugosllav ka qenë politik dhe jashtëgjyqësor: presidiumi i Kuvendit të ish-**Jugosllavisë** komuniste ka bërë kontrollin kushtetues të ligjeve republikane për të parë nëse ato binin ndesh me Kushtetutën Federale, kurse presidiumet e kuvendeve republikane bënin të njëjtën gjë sa i përket përputhshmërisë së ligjeve republikane me Kushtetutën Republikane[6]. Ky model ka qenë i kopjuar nga ish-**Bashkimi Sovjetik,** kurse është braktisur pas vitit 1963, kur u themelua **GJKRSFJ**.[7] Themelimi i saj u pasua nga themelimi i gjykatave kushtetuese republikane. Ani se gjyqësia kushtetuese në nivel ish-jugosllav dhe republikan ushtrohej sipas **modelit kelsenian/evropian** të gjyqësisë kushtetuese, për një kohë të gjatë pas vitit 1963 qenë ruajtur reliktet e kontrollit kushtetues politik jashtëgjyqësor: u ruajt e drejta e kuvendeve si organe më të larta të pushtetit unik, në nivel federal dhe republikan për të ushtruar kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve gjatë kohë së prodhimit të tyre nga kuvendi respektiv.[8]

Gjyqësia kushtetuese jugosllave ka qenë me kompetenca të përcaktuara kushtetuese bazuar në pozitën kushtetuese të federatës, republikave dhe dy krahinave autonome (Kosovës dhe Vojvodinës). Me fjalë tjera, kanë ekzistuar tri vija të mbrojtjes së kushtetutshmërisë në territorin e ish-**Jugosllavisë**. Përveç kësaj, krahas kontrollit të kushtetutshmërisë ka ekzistuar edhe kontrolli i ligjshmërisë, në tri nivelet, pra mbrojtja e ligjshmërisë në nivel federal, republikan dhe krahinor. Kjo nënkupton se **GJKRSFJ** ka mbrojtur kushtetutshmërinë e federatës, gjykatat kushtetuese republikane dhe krahinore kanë mbrojtur kushtetutshmërinë në nivel republikan, përkatësisht në nivel krahinor. E njëjta ka vlejtur, **mutatis mutandis**, edhe për ligjshmërinë.

---

4 Dragan M. Stojanovic, *USATAVNO PRAVO.* Knjiga I (Bona Fides : Nis, 2001) fq. 187-192.

5 Branko Smerdel, *USTAVNO UREDENJE EUROPSKE HRVATSKE* (NARODNE NOVINE: Zagreb, 2011) fq. 45-46.

6 Kjo bëhej me qëllim të ruajtjes së konceptit federal të shtetit ish-jugosllav, i cili konsiderohej si bashkim vullnetar i gjashtë republikave dhe popujve të tyre, ashtu që ligjet republikane duhej të ishin në pajtim me Kushtetutën e ish Federatës komuniste, por jo edhe kushtetutat republikane, pikërisht si pasojë e këtij koncepti mbi bashkimin vullnetar. Në praktikë, megjithatë, kushtetutat republikane nuk kishin asnjë dallim ndërmjet veti dhe konceptualisht i ngjasonin fort njëra-tjetrës dhe, të gjitha së bashku, i ngjasonin Kushtetutës Federale. Cf. Svetomir Škarić, *USTAVNO PRAVO* (KULTURA: Skopje, 2015) (botimi i tetë, vetëm në gjuhën maqedonase, alfabeti cirilik) fq. 924-926.

7 Në fillim të viteve ‘60 të shekullit të kaluar u duk sikur në vendet komuniste të Evropës do të futej gjyqësia kushtetuese e ndarë, e modelit kelsenian, mirëpo kjo nuk doli të jetë e saktë si pasojë e zhvillimeve politike (intervenimi sovjetik në Çekosllovaki në vitin 1968 dhe ngjarjet e tjera). Kontrolli politik i kushtetutshmërisë së ligjeve ngeli në duart e trupave të kuvendeve të dominuara nga komunistët, kurse kontrolli gjyqësor i kryer nga një gjykatë e ndarë kushtetuese, modeli kesenian, u cilësua si një prodhim borgjez, reaksionar dhe i padenjë për sistemin komunist. Cf. më shumë në Rhett Ludwikowski, “Judicial Review in the Socialist Legal System: Current Developments” *The International and Comparative Law Quarterly,* Vol. 37, No. 1 (Jan., 1988), fq. 89-108 në fq. 90-96.

8 Vesela Mukoska – Cingo, *Konstitucionalizam* (Univerzitet Sv. “Kiril i Metodij” – Pravni Fakultet “Justinijan Prvi”: Skopje 2006) (dispensë, vetëm në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik) fq. 508.

GJKRSFJ ka pasur kompetencat e veta të përcaktuara në nenin 375 ["Gjykata Kushtetuese e Jugosllavisë"] të Kushtetutës së vitit 1974, e cila ka qenë në fuqi deri në kohën e shpërbërjes së shtetit në prill të vitit 1992. Ato kompetenca kanë pasur të bëjnë me vendosjen lidhur me:

- pajtueshmërinë e ligjeve me Kushtetutën;
- papajtueshmërinë e ligjeve republikane dhe krahinore me ligjet federative;
- pajtueshmërinë e dispozitave të akteve të përgjithshme dhe vetëqeverisëse të organeve federative më Kushtetutën dhe ligjet federative;
- pajtueshmërinë e dispozitave të akteve të përgjithshme dhe vetëqeverisëse të bashkësive shoqërore-politike me Kushtetutën dhe me ligjet federative në rastet kur për zbatimin e tyre janë përgjegjëse organet federative;
- konfliktin për kompetencë në mes të Federatës dhe Republikës përkatësisht krahinës autonome, në mes të republikave dhe krahinave autonome si dhe në mes të bashkësive shoqëroro-politike të republikave të ndryshme, nëse për zgjidhjen e këtyre konflikteve nuk është parashikuar kompetenca e ndonjë organi tjetër;
- konfliktin për kompetencë në mes të gjykatave kushtetuese republikane përkatësisht krahinore në mes të gjykatave dhe organeve tjera shtetërore nga territoret e disa republikave përkatësisht krahinave autonome.

Sikundër vërehet, **GJKRSFJ** nuk e ka pasur në kompetencë të saj vlerësimin e kushtetutshmërisë së kushtetutave republikane dhe krahinore. Kjo në asnjë mënyrë nuk ka nënkuptuar se kushtetutat republikane, përkatësisht krahinore, kanë mundur të jenë në kundërshtim me Kushtetutën Federale. Një pamundësi e tillë përcaktohej qartë në nenin 206.1 të Kushtetutës së ish-**Jugosllavisë** të vitit 1974[9]. Një qasje kushtetuese si kjo tregon se qëllimi primar i Kushtetutës Federale ka qenë ruajtja e balanseve kushtetuese dhe politike në nivel federal duke iu lënë republikave dhe krahinave një hapësirë të madhe veprimi lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në nivel republikan, përkatësisht krahinor[10]. Mospasja e kësaj kompetence, në të njëjtën kohë, flet për një cilësi themelore të **GJKRSFJ**, përkatësisht se ajo nuk ka qenë instancë e fundit në çështjet kushtetuese, por instancë e parë dhe e fundit në çështjet kushtetuese të karakterit federal (nacional), cilësi të cilën e kanë pasur edhe gjykatat kushtetuese republikane, përkatësisht krahinore për çështjet kushtetuese në nivel republikan, përkatësisht krahinor. Kjo për arsye se gjyqësia kushtetuese në nivel jugosllav ka qenë e bazuar në parimin federal. Ky parim përbën edhe vetë thelbin e arsyes së lindjes së gjyqësisë kushtetuese sipas modelit **evropian/kelsenian** në truallin jugosllav.

Parimin federal duhet të parë si vetë themelin mbi të cilin qëndron arsyeja e lindjes së gjyqësisë kushtetuese jugosllave, e asnjëherë synimi për mbrojtjen e parimeve të demokracisë kushtetuese liberale. Kjo sepse demokracia kushtetuese liberale ka qenë në tërësi e panjohur në kushtet e sistemit kushtetues socialist të bazuar në ideologjinë komuniste jugosllave.[11]Parimi federal jugosllav ka shërbyer si themel për ndërtimin e një hierarkie të ashpër të dispozitave kushtetuese dhe ligjore. Kjo hier-

---

9 Neni 206.1 ["Kushtetutshmëria dhe Ligjshmëria"] i Kushtetutës: "Kushtetuta republikane përkatësisht krahinore nuk mund të jenë në kundërshtim më Kushtetutën e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë".

10 Milovan Buzandzić, *Sećesija bivsih jugoslovenskih republika u svetlosti odluka Ustavnog suda Jugoslavije. Zbirka dokumenata s uvodnom raspravom* (NIU "Sluzbeni list SRJ": Beograd, 1994) (në gjuhën serbe, alfabeti cirilik) fq. 16-17.

11 Në literaturën jugosllave të së drejtës kushtetuese, pa asnjë përjashtim, ka qenë e zakonshme të thuhet se lindja e gjyqësisë kushtetuese jugosllave ka pasur të bëjë edhe me mbrojtjen e individit dhe të drejtave të tij themelore dhe lirive të garantuara me kushtetutë. Kjo, megjithatë, nuk mund të jetë e vërtetë sepse vetë esenca e sistemit kushtetues dhe politik jugosllav, si dhe i çdo vendi tjetër komunist, ka konsistuar në mohimin e rolit të individit në shoqëri dhe në ruajtjen e asaj që njihet si legaliteti socialist. Me këtë term nënkuptohet qasja sipas së cilës në të gjitha vendet ish-komuniste, shteti dhe e drejta janë në funksion të ruajtjes, me metoda represive, të interesave të shtetit socialist, ku interesi individual në tërësi i nënshtrohet këtij interesi të shtetit socialist dhe të drejtës së tij. Cf. më shumë për autorët më eminentë jugosllavë që kanë theksuar se nevoja për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut ka qenë ndër arsyet kryesore për themelimin e gjyqësisë kushtetuese jugosllave: Dimitrije Kulic, *USTAVNO SUDSTVO U SVETU* ("Naša Reć" : Leskovac, 1972) fq. 157-190; Jovan Gjorgjeviq, *E DREJTA KUSHTETUESE* , fq. 770-773 & 782-787.

arki fillonte me **Kushtetutën Federale**, të drejtën kushtetuese federale, dhe mbyllej me kushtetutën republikane dhe të drejtën republikane. Pas amendamenteve kushtetuese të vitit 1969, 1971, 1972 dhe nxjerrjen e **Kushtetutës së Kosovës** të vitit 1974, e njëjta vlen edhe për Kosovën dhe të drejtën e saj kushtetuese. E drejta republikane/ krahinore duhej të ishte në harmoni jo vetëm me kushtetutën republikane, por edhe me të drejtën federale. Në mënyrë të ngjashme, e drejta republikane/krahinore duhej të ishte në harmoni me të drejtën federale, kurse e drejta federale duhej të ishte në harmoni me **Kushtetutën Federale**. Sikundër vërehet dhe siç u konstatua më sipër, nuk ka pasur një hierarki të gjyqësisë kushtetuese jugosllave, pra gjyqësia kushtetuese federale ka ekzistuar si një mekanizëm për të mbrojtur kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë në nivel federal, kurse gjyqësia kushtetuese republikane/ krahinore ka shërbyer për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në nivel republikan/krahinor. Kjo ka qenë në tërësi në pajtim me konceptin e federalizmit jugosllav ku republikat dhe krahinat janë konsideruar si përbërës të atij federalizmi, kurse federata ka qenë një servis në shërbim të tyre dhe jo anasjelltas. Kjo shpjegohet edhe me faktin se konsensusi i republikave dhe krahinave ka qenë kyç për funksionimin dhe mbijetesën e asaj federate, diçka që serbët nuk e kanë pasur të qartë asnjëherë, gjë që provohet me faktin se ata në vitin 1989 nisën ofensivën për rikthim të Kosovës nën sundimin e vet me bindjen se interesat nacionaliste serbe mund të realizoheshin në kuadër të ridefinimit të mënyrës së funksionimit të **Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë** (RSFJ). Kjo ofensivë serbe u kurorëzua më datën 23 mars 1989, kur u suprimua autonomia e **Kosovës** dhe, një vit më pas, vendi u integrua në tërësi në sistemin kushtetues serb: nga kjo kohë, **Kosova** u sundua sipas praktikave ish-koloniale të guvernatorëve të instaluar nga Beogradi. Për këtë flasim më shumë në kapitullin e dhjetë të këtij libri.

Duke pasur parasysh këtë rend normativ dhe kushtetues mjaft të ashpër, pra këtë rregullativ juridiko-kushtetuese të bazuar në parimin e konsensusit në nivel federal në mes të ish-republikave dhe krahinave autonome, atëherë qartë shihet se ndarja horizontale e punës në mes të **GJKRSFJ** dhe gjykatave kushtetuese të republikave/krahinave autonome, pa asnjë përjashtim, ka qenë e varur nga ajo nëse rregullativa e dhënë koordinohej në pikëpamje të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në nivel federal me hapat në nivel republikan/krahinor të ndërmarrë me konsensus konform dispozitave të **Kushtetutës së RSFJ** të vitit 1974. Me një fjalë, kanë ekzistuar tërë kohën dy kushtetutshmëri dhe ligjshmëri: ajo me konsensus dhe koordinim në nivel federal dhe kushtetutshmëria e ligjshmëria republikane e krahinore që kishin jetë autonome në kuadër të sistemit unik kushtetues dhe ligjor jugosllav. Mbi bazën e kësaj logjike juridiko–kushtetuese në të cilën mbështetej parimi federal jugosllav, kanë qenë të caktuara edhe kompetencat e gjykatave kushtetuese në nivel republikan/krahinor në periudhën prej vitit 1963-1974 dhe më pastaj kanë vazhduar kësisoj deri në pavarësimin gradual të ish-republikave jugosllave dhe shpërbërjen totale të atij shteti në pranverën e vitit 1992.

Lidhur me vënien në lëvizje të **GJKRSFJ** kanë ekzistuar tri baza për vënien e saj në lëvizje, krahas të drejtës së saj që ta vë vetveten në lëvizje **sua sponte**, përkatësisht **ex officio**, diçka që duket si një relikt i huaj në praktikën moderne të gjyqësisë kushtetuese.

Baza e parë ka pasur të bëjë me subjektet klasike, apo të privilegjuara, të cilat nuk kanë asnjë nevojë për të arsyetuar shkeljen apo cenimin e ndonjë të drejte konkrete, qoftë të tyren apo të dikujt tjetër. Këto organe kanë qenë në rend të parë organet qendrore të Federatës, por edhe organet qendrore në nivel të republikës dhe krahinës autonome.

Baza e dytë ka pasur të bëjë me subjektet të cilët mund të pohonin se me aktin e përgjithshëm kishte ardhur deri te shkelja apo cenimi i ndonjë të drejte të tyre konkrete subjektive. Lidhur me këtë, pra me rastet kur dikush pohon se ka ardhur deri të cenimi apo shkelja e një të drejte subjektive, ekzistonin dy nën situata:

- kur pohohej se ishin cenuar apo shkelur të drejtat kushtetuese të bashkësive shoqëroro-poli-

tike (republikës, krahinës apo komunës së caktuar)[12]; dhe

- kur pohohej se ishin cenuar apo shkelur të drejtat kushtetuese të organizatave themelore të punës së bashkuar, të organizatave punuese apo të organizatave të përbëra të punës së bashkuar[13].

Baza e tretë dhe e fundit për vënien në lëvizje të procedurës pranë **GJKRSFJ** ka qenë mundësia për të kërkuar kontroll kushtetues të drejtpërdrejtë dhe abstrakt të kushtetutshmërisë së një ligji apo akti tjetër të përgjithshëm. Këtu ka ekzistuar një listë e gjatë e palëve të autorizuara për vënien e saj në lëvizje, por në rend të parë fjala ka qenë për personat fizikë, të cilët mund të konsideronin se me ndonjë ligj apo akt të përgjithshëm kishte ndodhur cenimi i një të drejte apo lirie të garantuar me Kushtetutë.

Vendimet e Gjykatës me të cilat konstatohej një papajtueshmëri e ndonjë norme me kushtetutë zbatoheshin ashtu që lihej **një afat prej gjashtë muajsh** që të bëhej harmonizimi i tyre me Kushtetutën. Sipas nenit 384 ["Gjykata Kushtetuese e Jugosllavisë"] të Kushtetutës, ky afat mund të vazhdohej edhe për gjashtë muaj tjerë. Vetëm pas kalimit të këtyre afateve, **GJKRSFJ** mund të merrte vendim përfundimtar për shfuqizimin e normave të cilat ishin cilësuar si kundërkushtetuese.

Pas rrënimit të ish-Jugosllavisë më 1992, dy vite pasi kishte mbaruar **Lufta e Ftohtë**, u krijuan pesë shtete nga territori i saj: **Republika e Bosnje–Hercegovinës**, **Republika e Kroacisë**, **RFJ** dhe **Republika e Maqedonisë**. Në një referendum të mbajtur në maj të vitit 2006, **Republika e Malit të Zi** u pavarësua nga **Republika Federale e Jugosllavisw** (RFJ), të cilën e kishte krijuar diktatori serb **Sllobodan Millosheviq** më 27 prill 1992 mbi rrënojat e **RSFJ**[14]. Shteti i fundit që doli nga rrënojat e ish-Jugosllavisë është **Kosova**. Rasti i Kosovës është **sui generis** në aspektin juridik ndërkombëtar për shkak se është shkëputur nga **Serbia**, jo nga **RSFJ.** Kjo e fundit, në aspektin juridik-ndërkombëtar është shpërbërë në prill të vitit 1992, kur është krijuar **RFJ**. Në atë vit, diktatori serb, **Sllobodan Millosheviq,** krijoi një entitet tjetër të ri me emër të ngjashëm me **RSFJ**, i cili u quajt **RFJ,** e cila përbëhej nga **Serbia dhe Mali i Zi**. Gjatë tërë kohës sa ka qenë në pushtet diktatori **S. Millosheviq**, serbët kanë insistuar në teorinë e tyre të çuditshme mbi kontinuitetin shtetëror në aspektin e të drejtës ndërkombëtare në mes të ish-**Jugosllavisë** të krijuar më 1 dhjetor 1918 dhe krijesës federale me të njëjtin emër të krijuar nga Serbia dhe Mali i Zi në prill të vitit 1992, e emërtuar si **RFJ.** Sipas kësaj teorie, ish- Jugosllavia e vitit 1918, e shpërbërë në mënyrë të dhunshme në prill të vitit 1992, paraqet kontinuitet të tërësishëm shtetëror juridiko-ndërkombëtar me **RFJ** të themeluar në prill të vitit 1992. Jo vetëm kaq! Këto dy shtete, sipas serbëve, përbëjnë kontinuitet (vazhdimësi) juridiko-ndërkombëtar të Mbretërisë së Serbisë. Si argument kryesor për këtë, teoria serbe e ka përdorur rrethanën se pas krijimit të atij shteti në vitin 1918, me emrin **Mbretëria SKS**, për një kohë të gjatë i njëjti kishte zbatuar dhe respektuar traktatet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të lidhura nga **Mbretëria e Serbisë** (1882-1918) me shtetet tjera. Kjo e fundit, Mbretëria e Serbisë, në nëntor të vitit 1918, një muaj para themelimit të Mbretërisë SKS, kishte aneksuar dhunshëm **Mbretërinë e Malit të Zi** (1909-1918). Sipas teorisë serbe dje dhe sot, kjo rrethanë paraqet argument shtesë për të provuar kontinuitetin shtetëror juridiko-ndërkombëtar të **Mbretërisë së Serbisë** me **Mbretërinë SKS** të themeluar në vitin 1918 dhe, siç u tha, për pasojë, edhe me Jugosllavinë e vitit 1992 të krijuar nga S. Millosheviq. Kjo teori, siç u konstatua, bazohet në faktin e pamohueshëm se në mes të dy luftërave botërore, por

---

12 Termi bashkësi shoqëroro–politike përdorej si term kushtetues në ish-Jugosllavi për këto entitete: republikat, krahinat autonome dhe komunat. Këto ishin persona juridik të së drejtës publike dhe kishin të drejta e detyrime të caktuara kushtetuese.

13 Organizata Themelore e Punës së Bashkuar, Organizata Punuese dhe Organizata e Përbërë e Punës së bashkuar kanë qenë tri modelet themelore të organizimit të ndërmarrësisë ekonomike komuniste, të ngjashme me kompanitë apo firmat tregtare që ekzistojnë në kohën bashkëkohore aktualisht.

14 Shih më shumë për këtë në Enver Hasani, "Self-Determination under the Terms of the 2002 Union Agreement between Serbia and Montenegro: Tracing the Origins of Kosovo Self-Determination", botuar në *Chicago Kent Law Review*, Vëllimi 80 Nr. 1 (2005); Enver Hasani, "The Evolution of Succession Process in Former Yugoslavia", botuar në *Tomas Jefferson Law Review* Vol. 29 No. 1 2006 (SHBA), ribotuar edhe në *Miskolc Journal of International Law* Vol. 4 No. 2 2007, Hungari; Enver Hasani, "Specifikat e trashëgimit të ish-Jugosllavisë dhe pozita e Kosovës në të", botuar në E *DREJTA/LAW* nr. 1/2012 , revistë për çështje juridike dhe shoqërore e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës (Prishtinë, Kosovë).

edhe më pas, ish-Jugosllavia ishte shërbyer për një kohë me traktatet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të **Mbretërisë së Serbisë** (që ka ekzistuar deri në vitin 1918, pra deri në themelimin e **Mbretërisë SKS** më 1 dhjetor 1918).

Kjo teori serbe, u mor vesh, nuk është pranuar asnjëherë në diskursin shkencor në kuadër të ish-Jugosllavisë, siç është diskursi i malazezve,[15] i kroatëve[16] dhe popujve tjerë, sikundër që nuk është pranuar as në diskursin shkencor ndërkombëtar[17]. Fakti se ish-Jugosllavia është shërbyer me marrëveshjet ndërkombëtare të **Mbretërisë së Serbisë,** shpjegohet me arsye pragmatike dhe nevojën e komunikimit ndërkombëtar të shtetit të ri jugosllav të krijuar më 1 dhjetor 1918 dhe moslejimin e vakumit juridik në marrëdhëniet ndërkombëtare të këtij shteti me subjektet tjera të së drejtës ndërkombëtare të kohës me të cilët **Mbretëria e Serbisë** kishte pasur marrëdhënie kontraktuale. Shfrytëzimi i infrastrukturës kontraktuale të ish-Mbretërisë së Serbisë nga ana e Mbretërisë SKS, pra nga shteti i ri jugosllav në mes të dy luftërave botërore, shpjegohet me normat e të drejtës ndërkombëtare mbi trashëgiminë e shteteve në traktatet ndërkombëtare dhe asnjëherë nuk mund të shërbejë si provë e pakundërshtueshme për ekzistimin apo mosekzistimin e kontinuitetetit shtetëror juridik-ndërkombëtar me shtetin pararendës, në këtë rast si dëshmi e kontinuitetit juridiko-ndërkombëtar të ish-Jugosllavisë me **Mbretërinë e Serbisë** dhe me **RFJ**-në e krijuar nga diktatori serb S. Millosheviq në prill të vitit 1992.

Edhe pas rrëzimit të diktatorit serb nga pushteti, në tetor të vitit 2000, dhe lidhjes së **Marrëveshjes së Vjenës mbi Trashëgimin e ish-Jugosllavisë** në vitin 2001, ku të gjitha ish-republikat jugosllave u pranuan si trashëgimtare të barabarta të ish-Jugosllavisë së vitit 1918, duke mos e pranuar Serbinë si trashëgimtare të vetme të ish-Jugosllavisë së vitit 1918, teoria juridike serbe ende vazhdon të insistojë në teorinë e njëjtë që thotë se nuk ka asnjë shkëputje në kontinuitetin shtetëror në mes të **Mbretërisë së Serbisë** (1882-1918), ish-Jugosllavisë (1918-1992) dhe krijesës së krijuar nga **S. Millosheviqi** në prill të vitit 1992, **RFJ**-së.[18]

Në këtë seksion ne flasim vetëm për gjyqësinë kushtetuese në ish-republikat jugosllave, tani shtete sovrane dhe të pavarura, duke e lënë **Kosovën** si shtet sovran dhe i pavarur, i krijuar në mënyrën **sui**

---

15 Mijat Šuković, *PODGORICKA SKUPSTINA 1918* (DOB: Podgorica, 1999) (Në këtë monografi, autori me fakte dokumenton në mënyrë jashtëzakonisht të saktë dhe në detaje manipulimet serbe me një kuvend kukull malazez, të mbajtur në **Podgoricë** në nëntor të vitit 1918, ku ka pasur edhe përfaqësues shqiptarë nga Gjakova sepse atëherë deri në lumin **Drin i Bardhë** në **Dukagjin** ka qenë sovraniteti i **Malit të Zi**. Në këtë kuvend, mbajtur nën diktatin e ushtrisë okupuese serbe të kohës, është vendosur që Mali i Zi të integrohet në Mbretërinë e Serbisë. Kjo e fundit , më pastaj më 1 dhjetor 1918, ka negociuar me kroatët dhe sllovenët, sërish me mashtrime dhe me dhunë, për t'u futur nën thundrën serbe të quajtur **Mbretëria SKS**, apo ish-Jugosllavia, e cila në vitin 1945, është transformuar në federatë komuniste dhe ka ekzistuar deri në vitin 1992 kur në prill të atij viti u themelua **RFJ**) ; Mijat Šuković, *USTAVNO PRAVO* (CID: Podgorica 2009) fq. 148-158; Cf. për pikëpamje të njëjta, shtjellimin e shkëlqyer të Srdja Pavlović **,** *Balkan Anschluss: The Annexation of Montenegro and the Creation of the Common South Slavic State* (Purdue University Press: West Lafayette, Indiana, 2008) , Chapter Five ("The Preparaions for the Great People's Assembly in Podgorica") fq. 145-174.

16 Josip Metelko, *SUKCESIJA DRZAVA S POSEBNIM OSVRTOM NA RASPAD BIVSE SFRJ* (Pravni fakultet u Zagrebu: Zagreb, 1999 (në kapitullin XI, autori flet në mënyrë elokuente për aspektet juridike të trashëgimit të shteteve që kanë lindur me rastin e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë në vitin 1992 dhe e jep një pasqyrë të mendimeve që flasin qartë kundër çfarëdo kontinuiteti shtetëror në mes të Mbretërisë së Serbisë dhe ish-Jugosllavisë si dhe prapavijat e një teorie të tillë serbe).

17 Cf. punimet tona si në fusnotën nr. 14, **supra**, si dhe autorët kryesorë të së drejtës ndërkombëtare, përfshirë autorët serbë para vitit 1990, ku dëshmohet se asnjëherë nuk ka pasur një pranim ndërkombëtar të kontinuitetit shtetëror juridik-ndërkombëtar në mes të Mbretërisë së Serbisë (1882-1918) dhe ish-Jugosllavisë (1918-1992) e as kontinuitet shtetëror juridik–ndërkombëtar të këtyre dy të fundit me **RFJ** (Serbia dhe Mali i Zi) që u krijua nga Millosheviq në vitin 1992.

18 Cf. Pavle Nikolić, *USTAVNO PRAVO* (Službeni list SRJ: Beograd, 1993) (në gjuhën serbe me alfabet cirilik) fq. 123-124 (ku autori i cilëson si secesioniste ish-republikat jugosllave kurse Serbinë dhe Malin e Zi, si formuese të Republikës Federative të Jugosllavisë në prill të vitit 1992, si kontinuitete dhe ruajtës të ish-Jugosllavisë); Dragan M. Stojanović, *USATAVNO PRAVO* , fq. 251-255 & 281-286 (ku autori e cilëson Mbretërinë e Serbisë si kontinuitet shtetëror juridik-ndërkombëtar me ish-Jugosllavinë e themeluar në vitin 1918, sikundër edhe me Republikën Federale të Jugosllavisë të themeluar në prill të vitit 1992); Ratko Marković, *USTAVNO PRAVO I POLITICKE INSTITUTCIJE* ("Službeni glasnik": Beograd, 2008) (në gjuhën serbe me alfabet cirilik) fq. 102-110 & 140-143 (ku autori angazhohet me bindje për cilësimin juridik të ish-Jugosllavisë si kontinuitet shtetëror juridiko-ndërkombëtar i Mbretërisë së Serbisë dhe, për pasojë, kontinuitet i njëjtë edhe i Republikës Federale të Jugosllavisë, të themeluar nga Millosheviqi, me ish-Jugosllavinë).

generis, për kapitujt tjerë të këtij libri. Të gjitha ish-republikat jugosllave, përveç **Kosovës**, kanë kontinuitet të tërësishëm me gjyqësinë kushtetuese të nisur më 1963 nën ish-Jugosllavi: festimet e përvjetorëve të gjyqësisë kushtetuese nëpër këto republika kanë për pikë referimi vitin 1963. Kjo, siç do të shihet më vonë, nuk ka mundur të ndodhë me Kosovën sepse diktatori serb, **Sllobodan Millosheviq**, pas marsit të vitit 1989, në mënyrë graduale shkatërroi çdo institucion krahinor, përfshirë **Gjykatën Kushteuese të KSAK**, që ishte krijuar në vitin 1972, dhe për çka flitet gjerësisht në kapitullin e dhjetë të këtij libri. Nga marsi i vitit 1989 e tutje, Kosova **de facto** ngeli pa asnjë institucion të saj autonom dhe u integrua në tërësi me forcë në sistemin juridiko–kushtetues, politiko–administrativ dhe socio-ekonomik të **Republikës së Serbisë**[19]. Kjo situatë ka zgjatur deri me hyrjen e trupave të NATO-s në Kosovë më 10 qershor 1999, kur Kosova u çlirua nga pushtimi serb i filluar në fund të viteve ’80 të shekullit të kaluar.

Kontinuiteti kushtetues i ish-republikave jugosllave në lëmin e gjyqësisë kushtetuese, u mor vesh, ka të bëjë vetëm me aspektin institucional. Kjo sepse kompetencat aktuale të gjykatave kushtetuese të ish-republikave jugosllave dallojnë dukshëm me kompetencat që ato i kanë pasur në kohën e ekzistimit të ish-Jugosllavisë. Ka dallime të mëdha, por në të njëjtën kohë, siç do të vërehet, ish-republikat jugosllave kanë ruajtur në vija të përgjithshme disa kompetenca nga e kaluara, siç janë, ta zëmë, kujdesi për ligjshmërinë, krahas kujdesit për kushtetutshmërinë, përcjellja e fenomeneve dhe dukurive antikushtetuese dhe antiligjore në shoqëri, si dhe informimi **ex officio** i kuvendit (parlamentit) republikan/krahinor për gjendjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Këto kompetenca janë relikte të së kaluarës pasi ato, si të tilla, kanë ekzistuar në të kaluarën nën ish-Jugosllavi dhe askund tjetër. Këto kompetenca duken të çuditshme për modelin **evropian/kelsenian** të gjyqësisë kushtetuese. Për këto dhe kompetencat e gjykatave kushtetuese të ish-republikave jugosllave, tani shtete sovrane dhe të pavarura, do flitet më shumë në vijim gjatë trajtimit të secilës prej tyre.

Bosnje – Hercegovina paraqet në kuadër të ish-Jugosllavisë një rast shumë specifik që buron nga historia tragjike e këtij vendi. Më 14 dhjetor 1995 në **Dejton** të Ohajos së SHBA-së u nënshkrua **Marrëveshja për Paqe**, e njohur si **Marrëveshja e Dejtonit**, me të cilën përfundoi konflikti shumë violent katërvjeçar. Marrëveshja krijoi **Gjykatën Kushtetuese e Bosnje-Hercegovinës (GJKBH)**, si një institucion i ri nacional, në kuadër të cilës gjenden edhe tre gjyqtarët ndërkombëtarë. Përvoja e kaluar e këtij vendi në gjyqësinë kushtetuese, e nisur në vitin 1963, në mënyrë

[19] Rrënimin e autonomisë së **Kosovës** në mars të vitit 1989 dhe reintegrimin e tërësishëm të Kosovës në sistemin juridik-kushtetues, administrativ-politik dhe socio-ekonomik serb, autorët e të drejtës kushtetuese serbe e shohin si një sukses të madh të tyre që ka ndodhur në vigjilje të shpërbërjes së shtetit jugosllav. Ky proces i shpërbërjes ka nisur në vitin 1990 dhe ka përfunduar në prill të vitit 1992 me themelimin e **RFJ**. Sipas serbëve, ndërkaq, me rrënimin e autonomisë së **Kosovës** në mars të vitit 1989 dhe reintegrimin e Kosovës në tërësi në sistemin serb juridiko–kushtetues, administrativo–politik dhe socio-ekonomik, **Serbia** ka arritur të rikthejë shtetësinë e humbur gjatë sundimit të Kushtetutës së vitit 1974. Në diskursin kushtetues dhe politik serb, **Kushtetuta e RSFJ** e vitit 1974 shihet si shkaktari kryesor i shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Kjo sepse, sipas tyre, kjo kushtetutë e kishte ndarë **Serbinë** në tri pjesë përmes krijimit të dy krahinave autonome në kuadër të saj, përkatësisht të **Kosovës** dhe **Vojvodinës,** të cilat kishin autorizime të gjëra gjysmështetërore dhe të ngjashme me ato të republikave federale. Kjo, u mor vesh, nuk është e saktë sepse fjala nuk ka qenë për unifikim të **Serbisë** por për fillim të procesit të shpërbërjes së ish-**Jugosllavisë** përmes luftërave për pavarësi nga sundimi hegjemonist serb që kishte qenë prezent përgjatë shumicës së kohës sa ka eksistuar ish-**Jugosllavia** (1918-1992). Cf. për pikëpamjet e autorëve serb në Pavle Nikolić, *USTAVNO PRAVO* , fq. 113-124; Dragan M. Stojanović, *USATAVNO PRAVO.* Knjiga I, fq. 275-281; Liljana Slavnić, *USTAVNO PRAVO* (Privredna akademija: Novi Sad, 2007) (në gjuhën serbe me alfabet cirilik) fq. 122; 128-132; 385-389; Ratko Marković, *USTAVNO PRAVO I POLITICKE INSTITUTCIJE ,* fq. 137-143; Për mendimet e kundërta me autorët serbë të së drejtës kushtetuese, cf. në Mijat Sukovic, *USTAVNO PRAVO* , fq. 148-162 (ku autori përshkruan historinë politike dhe kushtetuese të Malit të Zi që ka synuar çdoherë për të hequr qafe hegjemoninë serbe gjatë kohës së ish-Jugosllavisë në vitet 1918-1992 dhe pas tyre deri në pavarësimin e këtij vendi në qershor të vitit 2006); Branko Smerdel, *USTAVNO UREDENJE EUROPSKE HRVATSKE* , fq. 241-245 (ku autrori përshkruan historinë politike dhe kushtetuese të popullit kroat për të hequr qafe sundimin serb gjatë tërë kohës së ekzistimit të ish-Jugosllavisë deri në shpërbërjen e saj në prill të vitit 1992); Prof.dr. Kurtesh Salihu, *LINDJA, ZHVILLIMI, POZITA DHE ASPEKTET E AUTONOMITETIT TË KRAHINËS SOCIALISTE AUTONOME TË KOSOVËS NË JUGOSLLAVINË SOCIALISTE* (ENTI I TEKSTEVE DHE I MJETEVE MËSIMORE I KTRAHINËS SOCIALISTE AUTONOME TË KOSOVËS: Prishtinë, 1984), kapitulli i parë (“LINDJA E AUTONOMISË SË KOSOVËS GJATË LNC DHE REVOLUCIONIT SOCIALIST”) dhe kapitulli i dytë (“POZITA KUSHTETUESE – JURIDIKE E AUTONOMISË SË KOSOVËS NË PERIUDHAT E DERITANISHME TË ZHVILLIMIT KUSHTETUES TË JUGOSLLAVISË SOCIALISTE”).

të njëjtë si me Kosovën, e nisur në vitin 1972, humbi dhe u tret në hijet e luftës dhe konfliktit të përgjakshëm me Serbinë. Për këtë arsye, në Bosnje–Hercegovinë, njëjtë si në Kosovë, çdo gjë është dashur të nisë nga e para.

Institucioni i **GJKBH**, i cili ka nisur punën më 1997, parashikohet me nenin VI të **Kushtetutës së Bosnje-Hercegovinës**, në ndërkohë që vetë Kushtetuta skicohet në Aneksin IV të **Marrëveshjes së Dejtonit**. Kjo do të thotë se Kushtetuta dhe Gjykata Kushtetuese janë pjesë e një detyrimi ndërkombëtar të këtij vendi. Kjo e fundit, për pasojë, ka për detyrim ruajtjen e rendit kushtetues dhe të ekuilibrave të brendshëm të përcaktuar me **Marrëveshjen e Dejtonit**.[20] Me nenin VI të Kushtetutës rregullohen kompetencat, organizimi dhe procedura, si dhe statusi përfundimtar dhe i detyrueshëm i vendimeve të gjykatës. Gjykata përcaktohet si një ruajtës i Kushtetutës dhe garantues i mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me kushtetutë dhe me dokumentet ndërkombëtare të numëruara në Aneksin I të Kushtetutës[21]. Sipas Kushtetutës, Gjykata vepron si një trup i pavarur kurse rregullat e procedurës i miraton vetë me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve. Këto rregulla, krahas Kushtetutës, paraqesin aktin e organizimit dhe të funksionimit të Gjykatës.

Gjykata përbëhet prej nëntë gjyqtarëve, gjashtë nga të cilët zgjidhen nga parlamentet e entiteteve (Dhoma e Përfaqësuesve e Federatës së Bosnje-Hercegovinës i zgjedh katër, kurse Kuvendi Popullor i Republikës Serbe dy)[22], kurse tre gjyqtarët ndërkombëtarë caktohen nga kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (**GJEDNJ)**.

GJKBH ka kompetencë të përcaktuar me Kushtetutë, e cila nuk mund të ndryshojë me ligj të veçantë. Kjo kompetencë ka të bëjë me të drejtën e Gjykatës për të vendosur:

- nëse ligjet e entitetit apo të shtetit si tërësi janë në pajtim me Kushtetutën e Bosnje–Hercegovinës, përfshirë këtu edhe vendosjen lidhur me kushtetutshmërinë e dispozitave të kushtetutave të dy entiteteve;
- lidhur me konfliktet për kompetencë sipas Kushtetutës në mes të entiteteve ose në mes tyre dhe Shtetit të Bosnje-Hercegovinës apo në mes të institucioneve të Bosnje-Hercegovinës;
- lidhur me çështjet që parashikohen në Kushtetutën e Bosnje-Hercegovinës kur ato bëhen çështje kushtetuese si pasojë e cilit vendim përfundimtar të një gjykate;[23]

---

20 Cf. Nicolas Maziau, "Chronique de jurisprudence de la Court constituionnelle de Bosnie-Herzegovine pour l'anne 1999". Në Giuseppe de Vergottini (ed.) *GIUSTIZIA COSTITUZIONALE E SVILUPO DEMOCRATICO NELL PAESI DEL' EUROPA CENTRO – ORIENTALE* (G. Giappicheilli Editore – Torino, 2000) fq. 97-100.

21 Këto dokumente pak a shumë janë të njëjta më ato të përcaktuara në nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të **Kushtetutës së Kosovës** të vitit 2008.

22 Sipas **Marrëveshjes së Dejtonit**, shteti i **Bosnje – Hercegovinës** përbëhet nga dy entitete: Federata e Bosnje – Hercegovinës dhe "Republika Srpska". Subjektivitet ndërkombëtar ka vetëm **Bosnje-Hercegovina** si shtet sovran dhe i pavarur, jo dhe entitetet në fjalë. Këto dy entitete po ashtu kanë gjykatat e tyre kushtetuese, mirëpo këtu nuk kanë rëndësi për ne sepse nuk përbëjnë gjykata kushtetuese të një shteti sovran dhe të pavarur. Cf. më shumë për këtë në punimin e shkëlqyer të njërit prej gjyqtarëve ndërkombëtarë në **GJKBH**, profesorit të njohur Jopseph Marko, "Five Years of Constitutional Jurisprudence in Bosnia and Herzegovina: A First Balance." *European Diversity and Autonomy Papers 7/2004.* Në internet: www.eurac.edu/edap (shikuar së fundi më 1 prill 2017). Në këtë punim autori flet për të gjitha aspektet e gjyqësisë kushtetuese në Bosnje-Hercegovinë dhe atë në mënyrë të zgjeruar.

23 Kjo kompetencë është e ashtuquajtura kompetencë ankimore e Gjykatës Kushtetuese, përmes së cilës mundësohet që individi t'i drejtohet **GJKBH** për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të tyre të garantuara me kushtetutë në rastet kur ata konsiderojnë se ato u janë shkelur apo cenuar me një vendim gjyqësor përfundimtar të ndonjë gjykate të rregullt në Bosnje-Hercegovinë. Ankesa kushtetuese mund t›i paraqitet Gjykatës vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike pranë gjykatave të rregullta në nivel nacional, njëjtë si në rastin e Kosovës. Edhe pse **Kushtetuta e Bosnje-Hercegovinës** parashikon se mund të ankimohet me ankesë kushtetuese vendimi përfundimtar dhe i formës së prerë i një gjykate të rregullt, Gjykata Kushtetuese, për dallim nga rasti i Kosovës, ka marrë qëndrim se individi mund të kërkojë mbrojtjen vetëm atëherë kur mendon se procedura pa arsye ka zgjatur shumë ashtu që individi nuk ka pasur asnjë mundësi që të marrë një vendim gjyqësor në afat të arsyeshëm. Duhet theksuar se, sikur në rastin e Kosovës, numri i lëndëve në **GJKBH** ka të bëjë kryesisht me lëndët e nisura sipas aneksit kushtetues, rrethanë që e bën këtë gjykatë të ngarkuar tej mase me lëndë të cilat vihen në lëvizje nga qytetarët e pakënaqur me vendimet e gjykatave të rregullta në nivel nacional.

- lidhur me çështjet e mbrojtjes së interesit nacional vital të kombeve konstitutive (që janë hisedarë) të Bosnje-Hercegovinës;
- lidhur me çështjet e ashtuquajtura kushtetuese, të cilat mund t'i ngre çdo gjykatë e entitetit, të cilat mund lindin gjatë vendosjes në një procedurë gjyqësore pranë gjykatave dhe që kanë të bëjnë me konstatimin nëse një ligj është në pajtim me Kushtetutën, KEDNj apo ligjet e Bosnje-Hercegovinës[24].

Sipas Kushtetutës, vendimet e saj janë përfundimtare dhe të detyrueshme. Çdokush që ka interes juridik mund të kërkojë që vendimi i Gjykatës të ekzekutohet. Kodi Penal, vlen të përmendet këtu, parashikon se moszbatimi i vendimit të **GJKBH** përbën vepër të veçantë penale.

Zhvillimi kushtetues në **Kroaci,** në kuadër të ish-Jugosllavisë, nuk dallon nga ai i ish-republikave jugosllave, tani shtete sovrane dhe të pavarura. Në esencë, përveç Bosnje-Hercegovinës, si pasojë e historisë së saj tragjike dhe gjenocidit kundër popullit boshnjak të shkaktuar nga forcat serbe, zhvillimi kushtetues i ish-republikave tjera jugosllave pak a shumë ka një ngjashmëri të përgjithshme. Kjo ngjashmëri vërehet edhe në zgjidhjet e dizajnit kushtetues dhe në formën institucionale të përzgjedhur për vënien në jetë të gjyqësisë kushtetuese në këto vende. Në të gjitha rastet, siç do të shihet në vijim, ka pasur një lloj kontinuiteti institucional me ish-Jugosllavinë, përkatësisht është ruajtur institucioni i Gjykatës Kushtetuese në nivel republikan, pak a shumë i njëjtë me kohën para vitit 1990, por me disa kompetenca shtesë që lidhen me natyrën e demokracive kushtetuese dhe mekanizmave të parashikuara për vënien e saj në jetë. Kjo natyrë nuk lejon për model tjetër të gjyqësisë kushtetuese në nivel të ish-republikave jugosllave pos të atij që siguron dhe mbron supremacinë (epërsinë) e kushtetutës dhe rendit objektiv të bazuar në të, ku ndarja e pushtetit dhe sundimi i ligjit, respekti për të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve përbëjnë postulatet dhe cilësitë dalluese. Në këtë kuptim, **Kroacia** ka pasur dy etapa të zhvillimit, sikundër edhe ish-republikat jugosllave, me përjashtim të **Bosnje-Hercegovinës**: kohën gjatë ish-Jugosllavisë dhe periudhën tjetër të zhvillimit kushtetues si shtet sovran dhe i pavarur.

Situata në **Kroaci** në kohën deri në vitin 1990, ka qenë pak a shumë e njëjtë me ish-republikat jugosllave. **Gjykata Kushtetuese e Kroacisë** (**GJKKr**) është themeluar më 1963 me kompetenca të njëjta sikur simotrat e saj në ish-republikat jugosllave dhe, më vonë, edhe me ish-gjykatat kushtetuese të dy krahinave autonome, Kosovës dhe Vojvodinës. Kushtetuta e vitit 1974 sërish ka përcaktuar kompetenca të njëjta të gjykatave kushtetuese, si në nivel federal, ashtu dhe në atë republikan/krahinor. Ato kompetenca që ka pasur **GJKKr** deri në vitin 1990, pak a shumë vlejnë**, mutats mutandis**, i kanë pasur edhe gjykatat kushtetuese në ish-republikat/krahinat jugosllave. Meqë **Kroacia**, sikundër ish-republikat/krahinat autonome, nuk ka qenë shtet sovran dhe i pavarur deri më 1990, atëherë as nuk ka rëndësi që të flitet më konkretisht për kompetencat e **GJKKr** para pavarësimit të saj.

Më 22 dhjetor të vitit 1990, **Kuvendi i Republikës së Kroacisë** ka nxjerrë Kushtetutën e re të shtetit sovran dhe të pavarur kroat, e cila me disa amendamentime të mëvonshme akoma është në fuqi[25]. Me nenet 125-131 të kapitullit V të **Kushtetutës së Republikës së Kroacisë** përcaktohen përbërja, përmbajtja dhe kompetencat e **GJKKr**. Në këtë libër flasim vetëm për kompetencat e gjykatave kushtetuese sepse ato shërbejnë si përcaktuesi vendimtar i sistemit/modelit të gjyqësisë kushtetuese të një vendi. Për organizimin, zgjedhjen dhe çështjet tjera të gjyqësisë kushtetuese flasim kalimthi më vonë kur të trajtojmë aspektet krahasuese të gjyqësisë kushtetuese kosovare dhe vendeve të tjera, si në aspektin organizativ, ashtu edhe në aspektin e vetëpërbërjes së gjykatave kushtetuese.

---

[24] Këtu, sikundër shihet, fjala është për **kontroll incidental të kushtetutshmërisë**, përkatësisht për kontroll të konvencionalitetit sepse fjala është për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (**KEDNJ)** për dispozitat e të cilës kujdeset **GJKBH** që të mos cenohen nga organet vendore gjyqësore, si dhe, farë në fund, për kontroll të ligjshmërisë meqenëse fjala është për kompetencën e saj që të kujdeset për respektimin e ligjeve të shtetit të **Bosnje-Hercegovinës** nga gjyqësori dhe organet tjera vendore.

[25] "Ustav Republike Hrvatske". *NARDNE NOVINE*, Br. 56 od 22 Decembera 1990. Amendamentet janë publikuar në *NARODNE NOVINE* Nr.: 135/97 (8/98 – teksti i konsoliduar), 113/2000 (124/2000 – teksti i konsoliduar) dhe 28/2001 (41/2001 – teksti i konsoliduar, 55/2001 - korrektim).

Sipas nenit 128 të Kushtetutës, **GJKKr** është kompetente për:

- vendosjen lidhur me pajtueshmërinë e ligjeve me Kushtetutën;
- vendosjen për pajtueshmërinë e dispozitave tjera me ligjin dhe Kushtetutën;
- kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e dispozitave, të cilat më nuk janë në fuqi nëse nga koha kur nuk janë në fuqi deri të paraqitja e kërkesës në Gjykatë, nuk kanë kaluar më shumë se një vit;
- vendosjen lidhur me ankesat kushtetuese kundër vendimeve të trupave shtetërorë, trupave të vetëqeverisjes lokale dhe regjionale si dhe kundër vendimeve të personave juridikë që kanë autorizime publike, kur, me këto vendime, janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore, si dhe të drejtat në vetëqeverisje lokale dhe regjionale të garantuara me Kushtetutë;
- vendosjen lidhur me ankesat kushtetuese kundër vendimeve individuale të organeve shtetërore, organeve të vetëqeverisjes lokale dhe regjionale si dhe kundër vendimeve të personave juridikë që ushtrojnë autorizime publike në rastet kur me këto vendime janë cenuar liritë dhe të drejtat themelore si dhe të drejtat në vetëqeverisje lokale dhe regjionale të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kroacisë;
- përcjelljen e realizimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë si dhe vënien re të dukurive të kundërkushtetutshmërisë dhe kundërligjshmërisë dhe lajmërimi i Saborit (Kuvendit) lidhur me këto dukuri;
- zgjidhjen e konfliktit për kompetencë në mes të organeve ligjvënëse, ekzekutive dhe gjyqësore;
- vendosjen në pajtim me Kushtetutën mbi përgjegjësinë e Presidentit të Republikës;
- mbikëqyrjen e kushtetutshmërisë së programeve dhe veprimtarisë së partive politike me mundësinë që, në pajtim me Kushtetutën, të urdhërojë ndalimin e punës së tyre;
- mbikëqyrjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së zgjedhjeve dhe referendumit shtetëror dhe zgjidhjen e kontesteve zgjedhore, të cilat nuk bien në kuadër të kompetencave të gjyqësorit; dhe, së fundi,
- kryerjen edhe të punëve tjera të përcaktuara me Kushtetutë.

Ligji Kushtetues mbi Gjykatën Kushtetuese (1999), i cili ka ndryshuar ligjin e njëjtë të vitit 1991, ka paraparë risi të konsiderueshme në punën e Gjykatës Kushtetuese.[26] Sipas nenit 63.1 ["Mbrojtja e të Drejtave dhe Lirive Themelore"] ankesa kushtetuese mund të paraqitet edhe para se të shteren mjetet tjera juridike, pra në mënyrë të drejtpërdrejtë, nëse pushteti publik nuk ka vepruar në afat të arsyeshëm në mbrojtje të të drejtave dhe lirive njerëzore.[27] Kjo dispozitë është futur në përgjigje të dënimeve që Kroacia ka marrë viteve të kaluara nga ana e GJEDNJ-së si pasojë e mosveprimit me kohë të organeve të shtetit në mbrojtje të të drejtave dhe lirive njerëzore dhe zvarritjeve të paarsyeshme të procedurave gjyqësore dhe procedurave tjera.

RFJ në vitin 2002 u transformua në **Unionin Serbi – Mali Zi** (USMZ). Sipas Marrëveshjes për **USMZ**, e lidhur në **Beograd** në mes të **Serbisë** dhe **Malit të Zi** më datën 14 mars 2002, parashikohej themelimi i një gjykate qendrore kushtetuese për tërë territorin e **USMZ**.[28] Kjo gjë nuk u realizua asnjëherë sepse ndodhi shpërbërja e këtij shteti më 2006, kur në qershor të atij viti, **Mali i Zi** shpalli pavarësinë me referendum. Shkëputja e **Malit të Zi** nga **USMZ** pati për pasojë që gjykatat kushtetuese të këtyre dy vendeve të vazhdojnë përvojën e tyre tradicionale të nisur në vitin 1963.

---

26 "Ustavni zakon o Ustavnom sudu Republike Hrvatske". Teksti i spastruar në *Nardone Novine* Nos. 99/99, 29/02 dhe 49/02.

27 Cf. Sanja Barić, "The Constitutional Court of the Republic of Croatia: Its Institutional Role Within the System of Government". Në Giuseppe de Vergottini (ed.) *GIUSTIZIA COSTITUZIONALE E SVILUPO DEMOCRATICO NELL PAESI DEL' EUROPA CENTRO – ORIENTALE,* fq.120-121.

28 "Polazne osnove za preuređenje odnosa Srbije i Crne Gore u okviru državne zajednice" (Beogradski Sporazum), *Međunarodna politika*, Dokumenti, Beograd, br. 1105, 2002, fq. I.

Për këtë arsye ne vazhdojmë diskutimin tonë për gjyqësinë kushtetuese në këto dy ish-republika jugosllave sipas rendit të tyre alfabetik.

Zhvillimin e gjyqësisë kushtetuese në **Mal të Zi** mund ta ndajmë në dy periudha. E para fillon me themelimin e **Gjykatës Kushtetuese të Malit të Zi** (GJKMZ) kurse e dyta nis me pavarësimin e **Malit të Zi** në qershor të vitit 2006, pas referendumit të mbajtur në maj të atij viti.

Në nenin 146 të Kapitullit VIII ["Kushtetutshmëria dhe Ligjshmëria"] të Kushtetutës së ish RSFJ të vitit 1963 qe parashikuar baza juridike për themelimin e gjykatave kushtetuese nëpër ish-republikat jugosllave. **Mali i Zi** ka themeluar Gjykatën Kushtetuese mbi këtë bazë.[29] Dy ish-krahinat autonome këtë të drejtë e kanë gëzuar vetëm me amendamentet kushtetuese të vitit 1971, diçka që flitet më vonë në kuadër të diskutimit tonë për zhvillimin historik të gjyqësisë kushtetuese kosovare. Në këtë libër nuk flitet për **Vojvodinën**, si një ish-krahinë autonome jugosllave, për arsye se akoma nuk është një shtet sovran dhe i pavarur. Zhvillimi i gjyqësisë kushtetuese në këtë njësi autonome, e cila tani gjendet nën sovranitetin e **Republikës së Serbisë**, ka pasur pak a shumë të njëjtën formë dhe përmbajtje me gjyqësinë kushtetuese të Kosovës. Sipas autorit të mirënjohur jugosllav, akademikut **Jovan Gjorgjeviq**, një konstitucionalist i njohur i asaj kohe dhe apogjeti kryesor i sistemit kushtetues e politik jugosllav, këto gjykata nëpër republika në qasje dhe parime të funksionimit kanë qenë të njëjta me gjyqësinë kushtetuese federale ish-jugosllave sa i përket mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në nivel republikan.[30] E njëjta ngjashmëri është reflektuar edhe në nivelin krahinor pas themelimit të dy gjykatave kushtetuese në **Vojvodinë** dhe në **Kosovë**. Kjo gjë shihet nga kompetencat e tyre shumë identike, gjë e cila buronte nga qëllimi i tyre kushtetues parësor: sigurimi dhe mbrojtja e supremacisë (epërsisë) së rendit kushtetues socialist jugosllav marrë si tërësi, si një sistem komunist specifik, siç thuhej e mendohej në atë kohë. Ky rend kushtetues bazohej në unitetin e pushtetit me kuvendin si organ më i lartë i pushtetit të klasës punëtore, i cili ushtrohej nga partia komuniste si avangardë e saj. Më vonë, pas vitit 1963, klasës punëtore si bartëse e pushtetit iu shtuan edhe segmentet tjera të popullit socialist vetëqeverisës, siç ishin fshatarët, inteligjenca, qytetarët dhe populli tjetër jo punues (siç cilësoheshin atëherë segmentet e caktuara të popullit, si në nivel federal ashtu dhe në atë republikan/krahinor)[31]. Sovraniteti i popullit dhe sovraniteti shtetëror u zëvendësuan me sovranitetin klasor, me sovranitetin e klasës punëtore në rend të parë, por edhe të shtresave të tjera siç ishin fshatarët, inteligjenca dhe qytetarët tjerë. Kjo ka qenë kështu sepse, sintagmat "populli punues" dhe "klasa punëtore" nuk reflektonin realitetin social dhe stratifikimet e tij që objektivisht ekzistonin në vendet ish-socialiste, ani se kushtetuta dhe ligjet si dhe vetë doktrina komuniste operonin me forma të ngurta për sa i përket klasave dhe shtresave tjera socio-ekonomike, socio-kulturore dhe socio-politike.

GJKMZ dhe ajo e ish-Jugosllavisë kanë pasur ngjashmëri të tërësishme, por në nivele të ndryshme. Në ndërkohë që GJKRSFJ ka mbrojtur kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë në nivel federativ, një gjë të tillë e ka kryer **Mali i Zi** sa i përket nivelit republikan. Kjo ka qenë kështu edhe me ish-gjykatat kushtetuese republikane/krahinore.

Me Kushtetutën e vitit 1963 për herë të parë u krijua **GJKMZ**. Me këtë kushtetutë qenë parashikuar kompetenca krejtësisht të njëjta me ato të gjykatave kushtetuese ish-republikave jugosllave. Ato kompetenca ishin për sa vijon:

- vendosjen lidhur me pajtueshmërinë e ligjeve republikane me Kushtetutën e Malit të Zi;
- vendosjen lidhur me pajtueshmërinë e statuteve të komunave me Kushtetutën e Malit të Zi dhe me ligjet republikane;
- vendosjen lidhur me pajtueshmërinë e dispozitave tjera dhe akteve të përgjithshme të organeve dhe organizatave me Kushtetutën e Malit të Zi, ligjet republikane dhe me dispozitat tjera republikane;

---

29 *Službeni list SRCG*, broj 1/63, Odluka o proglašenju Ustava SRCG, broj 329/1 od 10. aprila 1963. godine.

30 Dr. Jovan Gjorgjeviq*, E DREJTA KUSHTETUESE*, 795-798.

31 Cf. më shumë në Jovan Đorđević, *USTAVNO PRAVO* (Savremena Administracija: Beograd, 1976) fq. 112-114.

- zgjidhjen e kontesteve lidhur me të drejtat dhe detyrat ndërmjet Republikës dhe komunave, ndërmjet më shumë komunave si dhe ndërmjet komunave dhe organizatave në territorin e Republikës, nëse për zgjidhjen e kontesteve të tilla me ligj nuk parashikohej ndonjë kompetencë e një gjykate tjetër;
- vendosjen lidhur me konfliktin për kompetencë në mes të gjykatave dhe organeve republikane, si dhe ndërmjet gjykatave dhe organeve komunale në territorin e Republikës;
- kryente edhe punë tjera të cilat iu ishin lënë në kompetencë me Kushtetutën e Malit të Zi apo me ligj, në pajtim me të drejtat e detyrat kushtetuese që i kishte Republika në kuadër të sistemit kushtetues jugosllav;
- vendosjen lidhur me mbrojtjen e të drejtave të ashtuquajtura vetëqeverisëse dhe të drejtave dhe lirive tjera të përcaktuara me Kushtetutën e Malit të Zi në rastet kur ato ishin cenuar me akte apo veprime individuale të organeve të Republikës;
- vendosjen lidhur me çështjet tjera të përcaktuara me ligj dhe për të cilat nuk ishte siguruar mbrojtja tjetër gjyqësore.

Me Kushtetutën e vitit 1974 të **Republikës së Malit të Zi**, njëjtë si me rastin e ish-republikave jugosllave dhe dy krahinave autonome, nuk ka ardhur deri te ndryshimi substancial i kompetencave të **GJKMZ**. Kjo vlen edhe për **GJKRSFJ**, përveç ndonjë ndryshimi që ka pasur të bëjë me zgjerimin e rrethit të palëve të autorizuara dhe çështjet tjera teknike. Me një fjalë, kompetenca dhe fizionomia e gjykatave kushtetuese në nivel republikan/krahinor ka ngelur e njëjtë dhe ka ndjekur logjikën e kompetencave dhe fizionomisë së **GJKRSFJ**.[32] E njëjta gjë vlen edhe për ish-republikat jugosllave dhe zhvillimin e tyre kushtetues deri në shpërbërjen e ish-Jugosllavisë, proces që ka nisur në vitin 1990 dhe është mbyllur në pranverë të vitit 1992.

Me shpërbërjen e ish-Jugosllavisë në prill të vitit 1992, **Serbia dhe Mali i Zi** nxorën tri kushtetuta: një kushtetutë vlente për nivelin federal në mes të tyre sepse me referendum e kishin vendosur që të jetonin në një shtet të përbashkët, në **RFJ**,[33] kurse dy kushtetutat tjerat ishin kushtetutat e dy republikave, të cilat e përbënin këtë shtet të ri. **RFJ** shpresonte që, si pasojë e insistimit të diktatorit serb, **Slobodan Milloshevіq**, do të vijë deri te njohja e saj si një vazhdimësi juridiko-ndërkombëtare e shtetit tanimë të shpërbërë, ish-Jugosllavisë. Sa i përket anës juridiko-ndërkombëtare, nuk ka asnjë dallim në mes të Jugosllavisë së themeluar më 1 dhjetor 1918 si **Mbretëria SKS** (e riemërtuar në **Mbretëria e Jugosllavisë** më 1929) dhe Jugosllavisë komuniste të themeluar në vitin 1945. Nga ky vit e deri në shpërbërjen e vet në pranverë të vitit 1992, në aspektin juridik-kushtetues, ky shtet ka qenë i njohur si **RDFJ** (deri në vitin 1963) dhe **RSFJ** (nga 1963 deri në shpërbërje në vitin 1992). Në këtë aspekt, këtij shteti, **RFJ**, asnjëherë nuk iu është pranuar kontinuiteti (vazhdimësia) juridik-shtetëror me ish-Jugosllavinë (1918-1992). Lidhur me këtë ka pasur shumë mospajtime në mes të serbëve dhe popujve të tjerë. Në aspektin kushtetues kjo ishte krejtësisht e qartë: **RFJ**, e themeluar më datën 27 prill 1992, paraqiste një shkëputje radikale me sistemin e mëparshëm kushtetues të këtyre dy ish-republikave jugosllave. Teoricienët kushtetues serbë kanë synuar çdoherë që ta paraqesin të kundërtën e kësaj:[34] sipas tyre, përkundër ndryshimit kushtetues radikal dhe tektonik, revolucionar në tërësi, të kryer në prill të vitit 1992, ka ekzistuar kontinuiteti juridik-kushtetues në mes të **RFJ-së** dhe ish-Jugosllavisë (1918-1992).

RFJ ka qenë njëri nga pesë shtete sovrane dhe të pavarura të dala nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë në prill të vitit 1992. Në kuadër të tij kanë qenë **Kosova** dhe **Vojvodina.** Kjo e fundit si pjesë veriore e Serbisë, akoma gjendet në kuadër të saj. Kosova, ndërkaq, dhunshëm është integruar në Serbi pas marsit të

---

[32] Për rastin e **Malit të Zi** dhe vendin e tij në gjyqësinë kushtetuese ish-jugosllave, cf. më shumë në Hamdija Šarkinović, "Pola vijeka ustavnog sudstva u Crnoj Gori". *MATICA* br. 59 (Podgorica: jesen , 2014) fq. 85-97.

[33] "Ustav Savezne Republike Jugoslavije", *Službeni List Savezne Republike Jugoslavie*, br. 1/92 (Beograd).

[34] Cf. Pavle Nikolic, "La Justice constitutionnelle en Yougoslavie." Në Giuseppe de Vergottini (ed.) *GIUSTIZIA COSTITUZIONALE E SVILUPO DEMOCRATICO NELL PAESI DEL' EUROPA CENTRO – ORIENTALE* (G. Giappicheilli Editore – Torino, 2000) fq. 192-193.

vitit 1989, kur u bë suprimimi i autonomisë së saj nga ana e **Serbisë.** Për këtë arsye, në vijim japim kompetencat dhe veçoritë tjera të **Gjykatës Kushtetuese të RFJ** (GJKRFJ), jo të Vojvodinës dhe të Kosovës. Këtu nuk flasim as për **Gjykatën Kushtetuese të Serbisë** (GJKSrb) sepse në këtë kohë as Serbia nuk ka pasur subjektivitet juridik-ndërkombëtar të një shteti Sovran dhe të pavarur.

Sipas nenit 124 ["Gjykata Kushtetuese Federative"] të **Kushtetutës së RFJ** të vitit 1992, **GJKRFJ** ka pasur këto kompetenca:

- vendosjen lidhur me pajtueshmërinë e kushtetutës së njësisë federale (republikave) me Kushtetutën e Republikës Federale të Jugosllavisë;
- vendosjen lidhur me pajtueshmërinë e ligjeve, akteve tjera dhe dispozitave të përgjithshme me Kushtetutën e Republikës Federale të Jugosllavisë dhe me marrëveshjet e ratifikuara dhe të shpallura ndërkombëtare;
- vendosjen lidhur me pajtueshmërinë e ligjeve dhe të akteve dhe dispozitave tjera të përgjithshme të njësive federale (republikave) me ligjet federative;
- vendosjen lidhur me pajtueshmërinë me ligjin federativ të dispozitave dhe akteve tjera të përgjithshme;
- vendosjen lidhur me pajtueshmërinë me Kushtetutën dhe ligjet federale të akteve të përgjithshme të partive politike dhe shoqatave të qytetarëve;
- vendosjen lidhur me ankesat kushtetuese për shkak të cenimit përmes aktit individual apo veprimit tjetër të autoritetit publik të të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë;
- vendosjen lidhur me konfliktin për kompetencë në mes të organeve federale dhe organeve republikane si dhe në mes të organeve të republikave anëtare të Federatës;
- vendosjen lidhur me ndalimin e punës së partive politike dhe shoqatave tjera të qytetarëve; dhe
- vendosjen lidhur me cenimin e të drejtave gjatë zgjedhjeve për organet federale.

Sipas nenit të njëjtë, Gjykata ka mundur të vendosë edhe lidhur me kushtetutshmërinë e ligjshmërinë e akteve të cilat kishin pushuar së vlejturi, me kusht që nga dita e shfuqizimit e deri te nisja e procedurës pranë Gjykatës nuk kishin kaluar më shumë se një vit.

Gjykatat kushtetuese të dy republikave anëtare të **RFJ-së** kanë pasur kompetenca të ngjashme më kompetencat e **GJKRFJ**. Meqë fjala nuk ka qenë për shtete sovrane dhe të pavarura, siç thamë më sipër, këtu nuk diskutojmë gjykatat kushtetuese të këtyre dy njësive federale, por vetëm për **GJKRFJ**. Një status gjysmëkonfederal u krijua në vitin 2003 me miratimin e **Kartës Kushtetuese**, sipas së cilës **RFJ-ja** u shndërrua në **USMZ.**[35]Karta ishte rezultat i vënies në jetë të **Marrëveshjes së Beogradit** të vitit 2002 që parashikonte themelimin e USMZ. Me këtë kartë u krijua një gjykatë kushtetuese e çuditshme, si në formë ashtu dhe në përmbajtje. Siç u theksua më sipër, asnjëherë nuk ka ndodhur themelimi i saj. Ka rëndësi, megjithatë, që këtu të përfolën kompetencat e saj.

Në formë, sipas nenit 46 të kapitullit 4 ["Gjykata e Serbisë dhe Malit të Zi"] të Kartës, institucioni i ri që do t'i kryente detyrat e gjyqësisë kushtetuese në nivel të USMZ u quajt "gjykatë", por në përmbajtje fjala ka qenë për një gjykatë kushtetuese konfederale. Kjo është kështu sepse ajo gjykatë ka synuar që të ketë kompetenca të gjykatës klasike supreme për sa i përket funksionit **nomofilatik** (unifikues i praktikës gjyqësore në nivel nacional të USMZ). Një synim i tillë në mënyrë shprehimore reflektohej në paragrafin e fundit të nenit 46 të Kartës. Më këtë nen përcaktohej kompetenca e kësaj gjykate, e cila ka qenë dashur të jetë për si vijon:

- zgjidhjen e kontesteve në mes të institucioneve të Serbisë dhe Malit të Zi lidhur me kompetencat e tyre nga Karta Kushtetuese;
- zgjidhjen e kontesteve në mes të Serbisë dhe Malit të Zi lidhur me çështjet që bien në kompetencë të tyre;
- vendosjen lidhur me ankesat kushtetuese të qytetarëve në rastet kur institucionet e Serbisë apo Malit

[35] "Ustavna povelja Srbije i Crne Gore", *Međunarodna politika*, Dokumenti, Beograd, br. 1108, 2002, fq. IV.

të Zi cenojnë liritë dhe të drejtat e garantuara me Kartën Kushtetuese, por vetëm atëherë kur për këtë nuk ekziston një procedurë tjetër e mbrojtjes së tyre;
- vendosjen për harmonizimin e kushtetutave të shteteve anëtare me Kartën Kushtetuese;
- vendosjen për harmonizimin e ligjeve të Serbisë dhe Malit të Zi me Kartën Kushtetuese;
- vendosjen mbi harmonizimin e ligjeve të shteteve anëtare me ligjet e Serbisë dhe Malit të Zi; dhe, së fundi,
- vendosjen lidhur me ligjshmërinë e akteve administrative përfundimtare të institucioneve të Serbisë dhe Malit të Zi.

Në qershor të vitit 2006, sikundër u tha, **Mali Zi** shpalli pavarësinë e plotë nga Serbia dhe, në vitin në vijim, nxori një kushtetutë të re.[36] **Kushtetuta e Malit të Zi e vitit 2007** i jep kompetenca të qarta dhe më të ndryshme Gjykatës Kushtetuese, të cilat janë në përputhje me fizionominë e re të këtij vendi, tanimë shtet i pavarur dhe sovran.[37] Këto kompetenca përcaktohen në nenin 149 të pjesës së gjashtë ["Gjykata Kushtetuese e Malit të Zi"] të Kushtetutës dhe kanë të bëjnë me sa vijon:

- vendosjen lidhur me pajtueshmërinë e ligjeve me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara dhe të shpallura ligjërisht;
- vendosjen lidhur me pajtueshmërinë me Kushtetutën dhe ligjin e dispozitave tjera dhe akteve të përgjithshme;
- lidhur me ankesën kushtetuese për shkak të cenimit të të drejtave e lirive të garantuara me Kushtetutë, pas shterjes së mjeteve efektive juridike;
- vendosjen nëse Presidenti i Malit të Zi e ka shkelur Kushtetutën;
- vendosjen lidhur me konfliktin për kompetencë në mes të gjykatave e organeve tjera shtetërore, në mes të organeve shtetërore dhe organeve të njësive të vetëqeverisjes lokale si dhe në mes të organeve të njësive të vetëqeverisjes lokale;
- vendosjen lidhur me ndalimin e punës së partive politike dhe të organizatave joqeveritare;
- vendosjen lidhur me kontestet zgjedhore dhe referendumet, të cilat nuk janë në kompetencë të gjykatave tjera;
- vendosjen lidhur me pajtueshmërinë me Kushtetutën të masave dhe veprimeve të organeve shtetërore të ndërmarra gjatë kohës së gjendjes së luftës dhe gjendjes së jashtëzakonshme; dhe, së fundi,
- kryerjen e punëve tjera të përcaktuara me Kushtetutë.

Sipas paragrafit të parafundit të nenit 149 si më sipër, nëse gjatë vlerësimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë ka ardhur deri te pavlefshmëria e një dispozite, kurse nuk janë mënjanuar pasojat e zbatimit të saj, Gjykata përcakton nëse ajo dispozitë ka qenë në pajtim me Kushtetutën, përkatësisht në pajtim me ligjin gjatë tërë kohës sa ka vlejtur një dispozitë e tillë. Në paragrafin e fundit të po këtij neni theksohet detyra e Gjykatës për të përcjellë realizimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë si dhe dukuritë jo kushtetuese dhe joligjore si dhe njoftimi i Kuvendit të Malit të Zi për një gjë të tillë. Kjo kompetencë, siç u tha më herët, përbën një shmangie nga kompetencat klasike të gjykatave kushtetuese që modelohen sipas modelit klasik **kelsenian/evropian**.

---

[36] Sipas **Marrëveshjes së Beogradit të vitit 2002 për USMZ**, në rast të shkëputjes së Malit të Zi, Serbia trashëgonte të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga **Rezoluta 1244** dhe të gjitha të drejtat e detyrimet tjera që kishin të bënin me Kosovën. Këtë stipulim e kishin vënë serbët me shpresën se e drejta klasike ndërkombëtare do t'ia transferonte Serbisë në mënyrë automatike të gjitha të drejtat e detyrimet që kishin të bënin më **RFJ-në**, integritetit të së cilës i referohej **Rezoluta 1244.** Kjo, megjithatë, nuk doli të jetë kështu sepse në këtë rezolutë ka pasur edhe një stipulim tjetër që fliste për statusin e papërcaktuar **të Kosovës**, i cili duhej të caktohej sipas një procesi politik në mes të palëve më ndërmjetësim ndërkombëtar. Kjo dhe çështjet lidhur me këtë diskutohen në kapitullin e dhjetë të këtij libri në mënyrë të detajuar; Për pikëpamjet serbe lidhur me **Marrëveshjen e Beogradit për USMZ** dhe pritjet e tyre nga **Rezoluta 1244** pas shkëputjes së **Malit të Zi** në vitin 2006, Cf. në punimin e Ružica Mrdaković-Cvetković, *"Međunarodni kontinuitet Srbije posle odvajanja Crne Gore". Međunarodni Problemi* (Beograd) Vol. LVIII Br. 3 (July 2008) fq. 326-346 në fq. 329.

[37] Cf. Preambulla e Kushtetutës së Malit të Zi, në pesë paragrafët e saj e bën të qartë shtetësinë e re të këtij vendi, duke e cilësuar kuvendin që ka miratuar këtë kushtetutë si "kuvend kushtetutëbërës" me mandat të qartë që buron nga referendumi për pavarësi të Malit të Zi të datës 21 maj 2006. "Ustav Crne Gore". *Službeni List Crne Gore,* broj 1/07 (Podgorica: 2007) .

Në katër paragrafët e nenit 150 ["Procedura për Vlerësimin e Kushtetutshmërisë dhe Ligjshmërisë"] të Kushtetutës flitet për palët e autorizuara për të nisur procedurën e vlerësimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Sipas këtij neni, vënia në lëvizje e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë është shumë liberale dhe i takon, si një e drejtë e veçantë, çdo individi e gjykate, organi shtetëror apo organi të vetëqeverisjes lokale, sikundër dhe pesë deputetëve të **Kuvendit të Malit të Zi**. Kjo dispozitë lidhur me palët e autorizuara si dhe një pjesë e atyre që kanë të bëjnë me përcjelljen e dukurive dhe fenomeneve tjera jo kushtetuese e joligjore paraqesin një lloj relikti nga e kaluara ish-jugosllave, diçka që nuk gjendet në **Kushtetutën e Kosovës** (2008), si pasojë e dizajnit tjetër të gjyqësisë kushtetuese kosovare të ndikuar fort nga faktori ndërkombëtar, evropian dhe amerikan, kryesisht përgjatë draftimit të Kushtetutës. Ky ndikim i dyfishtë i këtyre dy sistemeve juridike, evropiane (kontinentale) dhe amerikane, në rastin e **Kosovës** ka prodhuar edhe një dokument tjetër që është më heterogjen në krahasim me **Malin e Zi** dhe ish-republikat jugosllave. Në këto të fundit ka pasur më shumë autonomi dhe partneritet të vendorëve me faktorin ndërkombëtar gjatë procesit të draftimit të teksteve të tyre kushtetuese pas fitimit të pavarësisë së tyre. Për këtë dhe çështjet lidhur me këto do të flasim në vijim të kapitullit dhjetë dhe tutje kur diskutojmë rastin e Kosovës dhe gjyqësinë e saj kushtetuese. Tani t'i kthehemi, sipas rendit alfabetik, **Maqedonisë së Veriut**, pastaj ish-partnerit të **Malit të Zi** deri në vitin 2006, **Republikës së Serbisë** dhe, në fund fare, **Republikës së Sllovenisë**.

Edhe në rastin e **Maqedonisë së Veriut** kemi tregimin e njëjtë sa i përket gjyqësisë kushtetuese në kuadrin ish-jugosllav.[38] Kompetencat dhe fizionomia e përgjithshme e **Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut** (GJKMV) deri në vitin 1990 kanë qenë të njëjta me ato të ish-republikave/krahinave jugosllave. Me shpërbërjen e ish-Jugosllavisë, proces i nisur në vitin 1990 dhe i përfunduar në pranverë të vitit 1992 me krijimin e **RFJ-së**, **Maqedonia e Veriut** u pavarësua e u bë një shtet sovran dhe i pavarur pa ndonjë vështirësi të veçantë në të cilën kishin hasur republikat tjera dhe Kosova gjatë pavarësimit të tyre nga Serbia. Konflikti me shqiptarët që nisi në vitit 2001 nuk preku në mënyrë esenciale rendin kushtetues maqedon dhe, për pasojë, as dizajnin kushtetutës të këtij vendi. Këtu bën pjesë edhe **GJKMV-ja**, e cila u transformua në një gjykatë të një vendi sovran dhe të pavarur në momentin e nxjerrjes së Kushtetutës së 17 nëntorit të vitit 1991, aktualisht në fuqi. Në sferën e gjyqësisë kushtetuese dhe mekanizmit institucional për vënien e saj në jetë, edhe në rastin e **Maqedonisë së Veriut** vlen prezumimi i ekzistimit të kontinuitetit (vazhdimësisë) juridiko-kushtetues të këtij vendi me kohën e ish-Jugosllavisë. Kjo nënkupton se **GJKMV-ja**, me juridiksion të modifikuar si pasojë e ndryshimeve rrënjësore në sistemin kushtetues pas fitimit të pavarësisë së vendit, në thelb është e njëjtë me atë gjykatë që ka nisur punën e saj në vitin tanimë të largët 1963.[39]

Sipas **Kushtetutës së Maqedonisë së Veriut** të vitit 1991, një ndër vlerat themelore të sistemit të ri kushtetues është ndarja dhe balancimi i pushteteve në pushtetin legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor.[40] Në kuadër të kësaj

---

38 Vesela Mukoska – Cingo, *KONSTITUCIONALIZAM*, fq. 508-509; Zoran Sulejmanov & Dejan Sulejmanov, *USTAVNO SUDSTVO* (Fleksograf: Kumanovo & Skopje, 2013) (në gjuhën maqedonase, alfabeti cirilik) fq. 731-734; Svetomir Skarić , *USTAVNO PRAVO, 923-930.*

39 Blaže Krcinski, "Neki problemi ustavnosudske kontrole u Makedoniji." *HRVATSKA I KOMPARATIVNA JAVNA UPRAVA*, br. 2 god. 11 (2011.) fq. 478-479.

40 Neni 8 i Kapitullit i ["Dispozitat Themelore"] të Kushtetutës: " Vlerat themelore të rendit kushtetues të **Republikës së Maqedonisë së Veriut** janë :

- liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe të qytetarit të garantuara sipas të drejtës ndërkombëtare dhe të njohura nga Kushtetuta;
- shprehja e lirë e identitetit nacional;
- sundimi i ligjit;
- ndarja e pushtetit shtetëror në legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor;
- pluralizmi politik dhe zgjedhjet e lira, të drejtpërdrejta dhe demokratike;
- mbrojtja ligjore e pronësisë;
- liria e tregut dhe e ndërmarrësisë;
- humanizmi, drejtësia sociale dhe solidariteti;
- vetëqeverisja lokale;
- planifikimi i duhur urban dhe rural me qëllimit të promovimit të një ambienti jetësor human si dhe mbrojtja dhe zhvillimi ekologjik; dhe
- respekti për normat përgjithësisht të pranuara të së drejtës ndërkombëtare".

ndarjeje, Kushtetuta nuk e fut Gjykatën në asnjërin prej tri pushteteve si më sipër, por i jep asaj një vend të veçantë në nenet 108-113 të kapitullit IV ["Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut"] të Kushtetutës. Siç do të shihet, kështu është rasti edhe me **Kushtetutën e Kosovës** dhe nenin e saj 4 ["Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit"] të Kushtetutës, siç është edhe me shumicën e vendeve ish-komuniste dhe vendet tjera të demokracive liberale kushtetuese tradicionale (Austria, Gjermania, Italia etj). Konform kësaj pikëpamjeje dhe kësaj qasjeje kushtetuese, **GJKMV-ja** paraqitet si një trup i veçantë i pushtetit shtetëror që është i ndarë në pikëpamje strukturore dhe funksionale nga tri pushtetet tjera në atë mënyrë që, sipas Kushtetutës, ushtron kontroll mbi të gjitha pushtetet tjera, përkatësisht kontroll të akteve dhe të veprimeve të tri pushteteve tjera shtetërore.[41]

Në mënyrë të njëjtë, si edhe të gjitha gjykatat tjera kushtetuese në vendet ish-komuniste dhe në demokracitë liberale kushtetuese, Gjykata ka juridiksionin e saj të përcaktuar me Kushtetutë. Ky juridiksion në rënd të parë konsiston në kontrollin kushtetues të akteve të përgjithshme dhe të akteve tjera juridike dhe veprimeve të pushteteve tjera. Si në rastin e ish-republikave jugosllave, Gjykata e ka të listuar në juridiksion të saj kushtetues edhe kontrollin e ligjshmërisë së akteve të përgjithshme dhe të akteve tjera juridike dhe veprimeve të pushteteve tjera. Përmes kësaj, Gjykata mbron kushtetutshmërinë e rendit juridik, pra mbron supremacinë (epërsinë) e Kushtetutës në kuadër të rendit juridik maqedonas. Këtë e bën, sikundër gjykatat tjera të vendeve ish-komuniste dhe të vendeve të proveniencës së demokracive kushtetuese liberale, përmes kompetencave të numëruara në mënyrë taksative në nenin 110 të Kapitullit IV ["Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut "] të Kushtetutës. Këto kompetenca, të cilat formojnë juridiksionin e qartë kushtetues të Gjykatës, janë si vijon:

- vlerëson pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën;
- vlerëson pajtueshmërinë e dispozitave tjera dhe marrëveshjeve kolektive me Kushtetutë dhe ligje;
- mbron liritë dhe të drejtat njerëzore;
- zgjidh konfliktet për kompetencë në mes të pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor;
- zgjidh konfliktet për kompetencë në mes të trupave shtetëror dhe njësive të vetëqeverisjes lokale;
- vendos lidhur me përgjegjësinë e Presidentit të Republikës;
- vendos lidhur me kushtetutshmërinë e programeve dhe statuteve të partive politike dhe shoqatave të qytetarëve; dhe
- vendos lidhur me çështjet tjera të përcaktuara me Kushtetutë.

Sipas nenit 113 të Kapitullit IV ["Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut] të Kushtetutës, Gjykata nxjerr rregullat mbi procedurën dhe punën e saj në mënyrë autonome. Sipas **Rregullave të Procedurës** (RP) nr. 394/92 të datës 9 nëntor 1992, të cilat aktualisht janë në fuqi, ndryshojnë palët e autorizuara për vënien në lëvizje të procedurës pranë Gjykatës në vartësi të çështjes kushtetuese.

Sa i përket kontrollit abstrakt, d.m.th. sa i përket kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve, si palë e autorizuar mund të paraqitet çdokush. Gjykata vendos vetë nëse do ta pranojë iniciativën për kontrollin e kushtetutshmërisë. Kjo përcaktohet me nenet 11 dhe 12 të kapitullit III ["Procedura për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së dispozitave dhe akteve tjera të përgjithshme"] të RP-së. Nenet tjera të RP-së rregullojnë ankesat individuale si dhe procedurat dhe

[41] Në fakt, kjo zgjidhje kushtetuese ekziston ndër ne dhe në shumicën e vendeve që kanë gjyqësi të ndarë kushtetuese nga gjyqësia e rregullt gjen përkrahje të gjerë në qarqet doktrinare. Nuk ka tjetër mënyrë për të arsyetuar vendin e gjykatave kushtetuese pos si organe shtetërore të ndara dhe të veçanta nga të gjitha të tjerat, që nuk i takojnë asnjërit prej pushteteve shtetërore, që ushtrojnë autorizime të qarta kushtetuese që kanë për qëllim sigurimin e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës dhe rendit objektiv kushtetues. Këtë mision primar nuk e kanë asnjëri prej tri pushteteve shtetërore. Kjo nuk do të thotë se gjyqësia kushtetuese është pushtet i katërt sepse, si e tillë, ajo na paraqitet si një veprimtari shtetërore e një organi të veçantë shtetëror i cili ka për qëllim të vetëm sigurimin e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës përmes interpretimit dhe vënies së saj në jetë, i kushtetutës së kuptuar zakonisht si një tekst koherent që përmban një tërësi të parimeve, vlerave dhe normave kushtetuese që kanë të bëjnë origjinën e pushtetit, mënyrën e ushtrimit të tij dhe rolin e pozitës dhe individit në shoqëri. Ky test nganjëherë mund të gjendet i shkapërderdhur edhe në tekste të tjera që kanë relevancë kushtetuese dhe që shërbejnë si parametër matës i nivelit dhe cilësisë së kushtetutshmërisë në një shoqëri.

punën e Gjykatës Kushtetuese në vijim të zbatimit të kompetencave të numëruara në nenin 110 si më sipër. Kjo në Kosovë si dhe në shumicën e vendeve tjera rregullohet me ligj, kurse me rregulla të brendshme rregullohen vetëm detajet teknike të procedurës dhe punës së institucionit të gjykatës kushtetuese. **Maqedonia e Veriut** nuk ka një ligj për Gjykatën Kushtetuese. Për këtë arsye këto çështje ligjore në këtë vend rregullohen me **RP-ja**, të cilat në mënyrë autonome përcaktojnë organizmin e punës dhe procedurat e Gjykatës Kushtetuese me qëllim të zbatimit të kompetencave të saj të përcaktuara me kushtetutë.

Në mënyrë të çuditshme, **RP-ja** e këtij vendi, në nenet 79-82 të kapitullit X ["Efektet Juridike të Vendime të Gjykatës Kushtetuese] rregullon të gjitha aspektet e efekteve juridike të vendimeve të Gjykatës. Këto aspekte në të gjitha rastet janë çështje që normohen me kushtetutë ose, në rastin më të keq, me ligje speciale që rregullojnë organizimin dhe punën e gjykatave kushtetuese. Meqë këto dhe çështjet e ngjashme me këtë janë të normuara me akt të brendshëm të **GJKMV**, nuk e shohim të udhës që të thellohemi më tutje sepse, tek e fundit, RP nuk prish natyrën dhe fizionominë e gjyqësisë kushtetuese në këtë vend. Vlen të theksohet se, për dallim nga disa prej ish-republikave jugosllave, përfshirë Kosovën, **GJKMV-ja** nuk e ka detyrim të saj përcjelljen e dukurive të jo kushtetutshmërisë dhe jo ligjshmërisë dhe as detyrim për të lajmëruar Kuvendin lidhur me këto dukuri. Ky relikt ish-jugosllav, me sa duket, është eliminuar nga rendi kushtetues i Maqedonisë.[42]

Serbia nuk bën asnjë dallim nga republikat tjera ish-jugosllave: **GKSrb** paraqet vazhdimësi institucionale që nga themelimi i saj më 1963 deri më sot. Dallimet aktuale të kësaj gjykate me atë të krijuar në vitin 1963 kanë të bëjnë me llojin e kompetencave, jo në aspektin institucional. Në aspektin juridiksional, Gjykata paraqet një gjykatë tipike të sistemit evropian, e modeluar sipas udhëzimeve të **Hans Kelsenit**, qëllim parësor i të cilës është ruajtja dhe sigurimi i supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës nacionale kundrejt çdo dispozite tjetër juridike apo veprimi. Si një nga gjykatat e një shteti sovran dhe të pavarur, Gjykata ka nisur jetën e saj njëjtë si **GJKMZ**, pra me ditën e shkëputjes dhe pavarësimit të **Malit të Zi** në qershor të vitit 2006, si pasojë e implementimit të rezultateve të referendumit për pavarësi në këtë të fundit që u mbajt në maj të vitit 2006.

Me **Kushtetutën e Republikës së Serbisë** të datës 8 nëntor 2006,[43] aktualisht në fuqi, janë bërë ndryshime të mëdha dhe risi në lëmin e gjyqësisë kushtetuese të këtij vendi. Kjo kushtetutë i jep **GJKSrb** kompetenca të reja dhe i zgjeron ato ekzistueset që kishin ekzistuar sipas Kushtetutës së vitit 1990. Në plotësimin e saj me gjyqtarë tani marrin pjesë në mënyrë të barabartë tri pushtetet, gjë që dallon nga gjykatat kushtetuese të ish-republikave jugosllave. Ligji për Gjykatën Kushtetuese rregullon organizimin e Gjykatës, procedurën para dhe efektet juridike të vendimeve të saj.[44]

Kompetenca e parë dhe themelore e **GJKSrb** është kontrolli normativ i së drejtës. Kjo kompetencë dukshëm është zgjeruar me Kushtetutën e vitit 2006. Tani ajo vendos jo vetëm lidhur me pajtueshmërinë e ligjeve dhe akteve tjera të përgjithshme me Kushtetutën por edhe lidhur me pajtueshmërinë e tyre me rregullat përgjithësisht të pranuara të së drejtës ndërkombëtare dhe me marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare.[45] Po ashtu, ajo vendos edhe lidhur me pajtueshmërinë e marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare me Kushtetutën.[46] Kushtetuta tani parashikon mundësinë e kontrollit kushtetues të ligjeve të

---

42 Shih më shumë për rastin maqedon në: Krčinski Blaže, "Ustavna žalba kroz jurispudencije ustavnog suda Makedonije". *Zbornik Radova Pravnog Fakulteta u Nišu* br. 64 (2013); Jeton SHASIVARI1, "Constitutional Judiciary in the Republic of Macedonia under the shadoë of its Fiftieth Anniversary-Situation and Prospects" *ACTA UNIVERSITATIS DANUBIUS* Vol. 9, No.3 (2013) .

43 *Official Gazette of the Republic of Serbia* No. 98/2006 (Belgrade).

44 Publikuar në *Službeni Glasnik Republike Srbije* No. 109/07 . Datë: 28 nëntor 2007, No. 99/11. Datë: 27 dhjetor 2011, No. 18/13 (CC) . Datë : 26 shkurt 2013, No. 40/15. Datë 7 maj 2015, dhe No. 103/15. Datë : 14 dhjetor 2015.

45 Neni 167 parag. 1. pika 1 i Ligjit.

46 Neni 167 parag. 1. pika 2 i Ligjit.

miratuara në Kuvend por që akoma nuk kanë hyrë në fuqi (kontrolli preventiv i kushtetutshmërisë). Kjo përbën të vetmen ngjashmëri të Kushtetutës së Serbisë, në lëmin e gjyqësisë kushtetuese, me juridiksionin e **GJKRKS**, të përcaktuar me Kushtetutën e vitit 2008, për të cilën flasim më pastaj në kapitullin e dhjetë e tutje.

Nuk janë të gjitha kompetencat e GJKSrb të përcaktuara me nenin 167 ["kompetencat"] të pjesës së gjashtë ["Gjykata Kushtetuese"] të Kushtetutës. Ato kompetenca sikur janë të shkapërderdhura nëpër tekstin e Kushtetutës. Disa janë në kuadër të pjesës së gjashtë, siç është rasti me dispozitat e nenit 170 ["Ankesa Kushtetuese"] të Kushtetutës , kurse tjerat jashtë kësaj pjese, siç është rasti me kompetencën nga neni 118 ["Shkarkimi'] të kapitullit 2 ["Presidenti i Republikës"] të pjesës së pestë ["Rregullimi i Pushtetit"] të Kushtetutës, kompetencë që ka të bëjë me autorizimin e Gjykatës për të vendosur për ekzistimin e përgjegjësisë së Presidentit të Republikës për shkelje të natyrës kushtetuese.

Neni 118 e rregullon procedurën e shkarkimit të Presidentit të Republikës. Në kuptim material, vendimi i **GKSrb** me të cilën konstatohet se Presidenti i Republikës e ka shkelur Kushtetutën mund të ketë vetëm karakter kështillëdhënës. Me një fjalë, këtu kemi të bëjmë me mendimin që konstaton ekzistimin e shkeljes së Kushtetutës nga ana e shefit të shtetit serb. Një vendim i tillë, megjithatë, nuk e detyron Kuvendin për ta shkarkuar Presidentin e Republikës. Zot i fatit të Presidentit të Republikës, në një rast të tillë, paraqitet Kuvendi i Serbisë, i cili me shumicën prej dy të tretave vendos lidhur me shkarkimin. Kjo është krejt njëjtë si në dispozitat e Kushtetutës së Kosovës që parashikojnë shkarkimin nga Kuvendi i Kosovës të Presidentit të Republikës bazuar në gjetjet e **GKSrb** (neni 91.1 i Kushtetutës). Në kuptimin procedural, vendimi i Gjykatës me të cilin konstatohet shkelja, është parakusht për vazhdim të mëtejmë të procedurës për konstatimin e përgjegjësisë së Presidentit. Kjo do të thotë se nëse ajo sjell një vendim që konstaton shkelje kushtetuese nga ana e Presidentit, ekzistojnë dy rrugë: e para, Kuvendi vendos për shkarkim ose mosshkarkim të Presidentit. Nëse vendos për mosshkarkim, atëherë Kuvendi konstaton shkeljen e tillë, mirëpo thotë se shkelja kushtetuese për nga vëllimi dhe përmbajtja e saj nuk çon në zbatimin ndaj Presidentit të sanksionit të shkarkimit. E dyta, kur ajo konstaton se Presidenti nuk ka shkelur Kushtetutën, atëherë procedura përfundon dhe mbyllet çdo gjë lidhur me këtë. Kjo nënkupton se Kuvendi nuk ka mundësi që të shkarkojë Presidentin në kundërshtim me vendimin e **GKSrb** me të cilin konstatohet se nuk ka pasur shkelje kushtetuese.

Ankesa kushtetuese, e rregulluar me nenin 170 të Kushtetutës, paraqet një institut të ri në sistemin kushtetues serb.[47] Kushtetutëbërësi serb nuk ka përcaktuar se kush mund ta paraqesë këtë mjet juridik. Kjo është për t'u çuditur! Këtë përcaktim ia ka lënë ligjvënësit. Ankesa kushtetuese, siç dihet, paraqitet si një mjet juridik me qëllim që gjyqësinë kushtetuese t'ia afrojë sa më afër qytetarit. Roli i saj është që të mbrojë të drejtat e qytetarëve, të shërbejë si një garant i sundimit të ligjit dhe që vlerat tjera të sistemit të demokracisë liberale kushtetuese të vijnë në shprehje sa më shumë që të jetë e mundur.

Kompetencat tjera të **GKSrb,** përveç këtyre si më sipër, janë të përcaktuar në nenin e sipërcekur 167 të Ligjit. Ky nen ka dy pjesë. Në pjesën e tij të parë përcaktohen këto kompetenca:

"[...] 2. vendosjen lidhur me pajtueshmërinë e marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare me Kushtetutën;

3. vendosjen lidhur me pajtueshmërinë e akteve tjera të përgjithshme me ligjin;

4. vendosjen lidhur me pajtueshmërinë e statuteve dhe akteve tjera të krahinave autonome dhe të njësive tjera të vetëqeverisjes lokale me Kushtetutën dhe ligjin;

5. vendosjen lidhur me pajtueshmërinë më Kushtetutën dhe ligjin të akteve të përgjithshme të organizatave të cilat ushtrojnë autorizime publike, të akteve të partive politike, të akteve të sindikatave

[47] Instituti i ankesës kushtetuese nuk ka qenë i parashikuar me Kushtetutën e Republikës së Serbisë të vitit 1990, por me Kushtetutën e RFJ-së (Serbi dhe Mali i Zi) të vitit 1992 (neni 124) dhe me Kartën për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut të vitit 2003 (neni 9).

dhe të shoqatave të qytetarëve dhe të kontratave kolektive".

Përveç këtyre, në pjesën e dytë të nenit 167 janë përcaktuar edhe kompetencat si në vijim:

"1. vendos lidhur me konfliktin për kompetencë në mes të gjykatave dhe organeve tjera shtetërore;

2. vendos lidhur me konfliktin për kompetencë në mes të organeve republikane dhe organeve krahinore si dhe në mes të organeve të njësive të vetëqeverisjes lokale;

3. vendos lidhur me konfliktin për kompetencë në mes të organeve krahinore dhe organeve të njësive të vetëqeverisjes lokale;

4. vendos lidhur me zgjidhjen e konfliktit për kompetencë në mes të organeve të ndryshme të krahinave autonome dhe njësive të ndryshme të vetëqeverisjes lokale;

5. vendos lidhur me kontestet zgjedhore në rastet kur me ligj për to nuk është caktuar kompetenca e gjykatave;

6. kryen edhe punë tjera të përcaktuara me kushtetutë dhe ligj".

Në paragrafin e fundit të nenit 167 përcaktohet kompetenca e fundit, të cilin e pamë më herët se ekziston edhe në kushtetutat e ish-republikave jugosllave, pra kompetenca e **GKSrb** për të vendosur lidhur me ndalimin e punës së një partie politike, një shoqate të qytetarëve apo të shoqatës sindikale. Një tjetër relikt ish-jugosllav prezent në gjyqësinë kushtetuese serbe është edhe nisja e procedurave pranë Gjykatës Kushtetuese **sua sponte** (me vetiniciativë). Kjo parashikohet në nenin 168 ["Vlerësimi i Kushtetutshmërisë dhe Ligjshmërisë"] të Kushtetutës.[48]

Krejt në fund, vlen të sqarohet për lexuesin se me termin "krahina" në Kushtetutën e Serbisë nënkuptohen **Kosova** dhe **Vojvodina**. Kjo qartë shihet në paragrafin e dytë të **Kushtetutës së Serbisë**, ku Kosova cilësohet si një autonomi substanciale brenda shtetit sovran të Serbisë. Ekspertët kushtetues serbë dhe establishmenti politik në Beograd e kanë parë të udhës që të përdorin një nivel shumë të lartë abstraksioni dhe ta krahasojnë Kosovën, një shtet sovran dhe i pavarur, me krahinën e Vojvodinës.[49] Kjo marrëzi kushtetuese bëhet, u mor vesh, për qëllime të politikës ditore dhe konsum të brendshëm politik serb. Se kjo është kështu nuk është fshehur aspak në tekstin e preambulës së **Kushtetutës së Serbisë**, fjalia e fundit e së cilës thekson se nisur "[...] nga statusi i tillë i Krahinës së Kosovës dhe Metohisë burojnë edhe detyrimet kushtetuese për të gjitha organet shtetërore për të mbrojtur dhe përkrahur interesat shtetërore të Serbisë në Kosovë dhe Metohi në të gjitha raportet e brendshme dhe ndërkombëtare".

5.2. Hungaria, Polonia dhe Çekosllovakia

Hungaria përbën precedentin më interesant dhe më të studiuar të krejt gjyqësisë kushtetuese të Evropës postkomuniste. Ky zhvillim ndahet në dy periudha kohore: e para, periudhë, të cilën ne do ta cilësojmë si periudha e artë e gjyqësisë kushtetuese hungareze, mbaron në vitin 2012, kur qeveria e djathtë nacionaliste e kryeministrit aktual **Viktor Orban** (Viktor Orbán) e kthen **Gjykatën Kushtetuese të Hungarisë** (GJKHu) nga një institucion me kompetenca të mëdha në një institucion me kompetenca të varfëra dhe krejtësisht pa ndikim në shoqërinë hungareze[50]. Periudha e dytë përfshin kohën nga viti 2012 e deri më sot. Kjo periudhë karakterizohet me një gjykatë kushtetuese që ka kompetenca

---

48 Për komentet rreth autorizimit për vënien në vetëlivzje, përkatësisht për vënien në lëvizje **sua sponte** (**ex officio**) në rastin serb, cf. *Maja Nastić*, "Constitutional Rievew of International Agreements: Comparative Law Perspective". **FACTA UNIVERSITATIS**: University of Niš, Faculty of Law, Serbia. **Law and Politics** Vol. 13 No. 1 (2015) fq. 59-72 në fq. 66-69 (kjo vlen në veçanti në lëmin e traktateve ndërkombëtare, si një autorizim policor i kësaj kushtetueseje për të kontrolluar aktivitetin ndërkombëtar të organeve shtetërore).

49 Cf. më shumë për komentet doktrinare të ekspertëve serbë të së drejtës kushtetuese në : Pavle Nikolic, *USTAVNO PRAVO* , fq. 437-438 ; Liljana Slavnić, *USTAVNO PRAVO* , fq. 385-389; Ratko Marković, *USTAVNO PRAVO I POLITICKE INSTITUTCIJE* , fq. 444-449.

50 Schnutz Rudolf Durr, "Comparative Overview of European Systems of Constitutional Justice". *Vienna Journal on International Constitutional Law,* Vol. 5 Issue 2 (2011) fq. 159-174 në fq. 174.

boshe dhe pa ndonjë ndikim në shoqërinë hungareze, diçka krejt e kundërt me periudhën e para vitit 2012. Ndryshimet kushtetuese të vitit 2011 kanë hyrë në fuqi më 1 janar 2012, kurse amendamentet e vitit 2013 i dhanë goditjen e fundit gjyqësisë së famshme kushtetuese që kishte nisur në këtë vend pas rrëzimit të komunizmit. Me këto ndryshime kushtetuese përfundimisht u zvogëlua roli i Gjykatës në shoqërinë hungareze. Tani e tutje Kushtetuta dhe supremacia (epërsia) e saj si dhe efekti i saj normativ i drejtpërdrejtë do të vihen në pikëpyetje sepse shumica konservative hungareze kishte arritur të kufizojë juridiksionin e Gjykatës në çështjet fiskale dhe në vendosjen lidhur me ndarjen e pushtetit në mes të ekzekutivit dhe legjislativit, si dhe t'i ndryshojë dispozitat për emërimin e gjyqtarëve të cilat tani e tutje nuk kërkonin konsensus ndërpartiak por vetëm shumicën e dy të tretave të deputetëve hungarezë. Përveç kësaj, qeveria e **Viktor Orbanit** zgjeroi numrin e gjyqtarëve të **GJKHu,** duke i caktuar gjyqtarët e vet aty me qëllim të ndikimit të vendimmarrjes në të ardhmen. Kjo situatë në literaturë është cilësuar si transformim i demokracisë kushtetuese liberale hungareze në një demokraci kushtetuese autoritare.[51]. T'i kthehemi tani diskutimit tonë të fazës së parë të zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese në këtë vend dhe të shohim cilësitë e kësaj faze.

Më 19 tetor 1989, **Parlamenti i Hungarisë** nxori një rezolutë me të cilën theksohej nevoja e themelimit të një gjykate kushtetuese. Organizimi dhe juridiksioni i saj, megjithatë, u përcaktuan më vonë gjatë kohës së negociatave, të njohura si negociata trilaterale të tryezës së rrumbullakët, të cilat sollën transformimin demokratik të sistemit kushtetues hungarez, ani se formalisht **Kushtetuta e Hungarisë** e vitit 1949 kishte ngelur në fuqi. Dispozitat themelore mbi **Gjykatën Kushtetuese të Hungarisë** u përcaktuan në tetor të vitit 1989, kur Parlamenti i Hungarisë votoi amendamentimet kushtetuese në Kushtetutën e vitit 1949. Në kuadër të këtyre amendamenteve të shumta bën pjesë edhe neni i ri 32A ["Autorizimet dhe Organizimi'] i kapitullit IV ["Gjykata Kushtetuese"] të Kushtetutës. Në paragrafin e vet të parë, neni theksonte se Gjykata Kushtetuese kishte për detyrë të vlerësonte kushtetutshmërinë e ligjeve, kurse në të tretin i jepte të drejtë çdokujt për të nisur procedurën për vënien në lëvizje të Gjykatës, pa pasur nevojë të specifikonte interesin juridik për një gjë të tillë. Kjo do të thotë se secili individ apo person juridik hungarez gëzonte statusin e subjektit të privilegjuar për të nisur procedurën e vlerësimit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve tjera juridike, si dhe të veprimeve të autoriteteve publike. Kjo e ka bërë **Hungarinë** të vetmin vend ish-komunist me **actio popularis**. Kjo dispozitë, në fakt, ka qenë kryesorja, e cila i ka dhënë namin **GJKHu** si një gjykatë jashtëzakonisht aktiviste dhe si një institucion kyç në trasimin e rrugës evropiane të këtij vendi, përkatësisht të rrugës së integrimit të **Hungarisë** në **Bashkimin Evropian**[52]. Kjo situatë ka zgjatuar deri me nxjerrjen e Kushtetutës së vitit 2011, e cila ka hyrë në fuqi më 1 janar 2012, e cila aktualisht është në fuqi së bashku me amendamentet e vitit 2013[53].

Më 8 shkurt të vitit 2013, qeveria e ekstremit të djathtë të kryeministrit **Viktor Orban**, duke pasur dy të tretat në **Parlamentin e Hungarisë**, paraqiti një propozim për amendamentimin e Kushtetutës së Hungarisë, që hyri në fuqi më 1 janar të vitit 2012. Ky propozim u miratua në Parlament më 11 mars 2013 me emrin Amendamenti i Katërt në Kushtetutën e Hungarisë. Ky amendament, siç ka konstatuar

---

51 Me termin konstitucionalizëm autoritar nënkuptohet situata kur një vend i përqafon cilësitë themelore të demokracisë kushtetuese, siç janë zgjedhjet e lira dhe pluraliste, një rol në dukje të gjykatave, por kur individi dhe të drejtat e liritë e tij i nënshtrohen kërkesave rigoroze të rendit dhe sigurisë publike. Të këtij lloji konsiderohen **Malejzia, Singapori, Turqia, Venezuela** etj. Cf. më shumë në Mark Tushnet, "Authoritarian Constitutionalism". *CORNELL LAW REVIEW* Volume 100 Issue 2 (January 2015) fq. 391-462; për rastin e **Hungarisë**, Ibid. fq. 433-435.

52 Cf. më shumë për këtë në: Nathan J. Brown and Julian G. Waller, "Constitutional courts and political uncertainty: Constitutional ruptures and the rule of judges. *International Journal of Constitutional Law* Vol. 14 No. 4 (2016) fq. 817–850 në fq. 823-825; Gábor Halmai, " National(ist) constitutional identity? Hungary's road to abuse constitutional pluralism." EUI Working Paper **LAW** 2017 / 08 (Italy) ; Gábor Halmai , "Silence of transitional constitutions: The "invisible constitution" concept of the Hungarian Constitutional Court". *International Journal of Constitutional Law* Vol. 16 No. 3 (2018) fq. 969–984 në fq. 971-977.

53 Ligji XXXII i vitit 1989 mbi Gjykatën Kushtetuese është nxjerrë nga Parlamenti më 19 tetor 1989, kurse Gjykata Kushtetuese ka nisur punën me 1 janar 1990. Hungaria ka qenë vendi i vetëm ish-komunist që nuk ka nxjerrë kushtetutë të re, por ka amendamentuar kushtetutën komuniste të vitit 1949.

me të drejtë **Komisioni i Venecias,**[54] rrënon sundimin e ligjit, duke futur në rendin kushtetues hungarez dispozita, të cilat më parë janë shpallur jo kushtetuese nga ana e **GJKHu** edhe dispozitat që cenojnë standardet ndërkombëtare, duke ulur dhe dobësuar shumë ushtrimin e kontrollit kushtetutshmërisë ndaj aktivitetit legjislativ të **Parlamentit të Hungarisë** nga Gjykata Kushtetuese.[55]

Derisa Kushtetuta e vitit 2011 u cilësua si një arritje dhe një progres në drejtim të zhvillimit të konstitucionalizmit hungarez, meqë sanksiononte në mënyrë përmbledhëse krejt të arriturat e këtij vendi pas rënies së komunizmit,[56] amendamentet e vitit 2013 u cilësuan si diçka mjaft e shëmtuar në lëmin e zhvillimit të konstitucionalizmit në këtë vend. Kjo shëmti u manifestua jo vetëm sa i përket cenimit të rolit dhe pozitës juridiksionale të Gjykatës Kushtetuese, por edhe në aspektet tjera, siç janë: familja, roli i kishës dhe i fesë në përgjithësi dhe në disa aspekte tjera. Ne këtu fokusohemi vetëm në ato pjesë të amendamentimit që kanë të bëjnë me ndryshimet në rolin dhe pozitën juridiksionale të Gjykatës Kushtetuese. Në këtë aspekt, tri janë ndryshimet që kanë të bëjnë me rolin dhe pozitën e Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë të cilat janë futur me amendamentimin e sipërcekur të vitit 2013: ***i pari*** ndryshim i deklaron si të pavlefshme vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë të dhëna para nxjerrjes së Kushtetutës së vitit 2011, aktualisht në fuqi nga 1 janari i vitit 2012; ***i dyti*** ndryshim ka të bëjë me ndalimin që Gjykata Kushtetuese të bëjë kontrollin kushtetues substancial (material) të amendamenteve kushtetuese; dhe, së fundi, ***i treti*** ndryshim ka të bëjë me zgjerimin e mëtejmë të kufizimeve të kompetencave të Gjykatës Kushtetuese.

Se amendamenti si më sipër do t'i shpallë të pavlefshme vendimet e Gjykatës Kushtetuese të dhëna në vijim të interpretimit të Kushtetutës së vitit 2011 u bë e qartë me ndryshimet që u bënë në preambulën e kësaj kushtetute. Tani, preambula e re, **inter alia**, theksonte se përfaqësuesit e sovranit hungarez më nuk e njohin kushtetutën komuniste të vitit 1949 sepse kishte qenë bazë e sundimit tiranik dhe, për pasojë, ajo shpallet e pavlefshme. Ky zotim preambular u operacionalizua në pjesën normative, në fund të amendamentit të katërt, në pjesën mbi dispozitat kalimtare. Në këtë pjesë u shtua një nen, neni 19, në të cilin thuhet shprehimisht se "[...] (5) vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe arsyetimet e tyre të dhëna para hyrjes në fuqi të Kushtetutës nuk mund të përdoren si bazë për interpretim të Kushtetutës". Me Kushtetutë këtu nënkuptohet Kushtetuta e Hungarisë e vitit 2011, e cila ka hyrë në fuqi më 1 janar 2012 dhe e cila akoma është në fuqi së bashku me amendamentin e katërt të cilin e diskutojmë këtu. Me këtë hap, hartuesit e amendamentit në fjalë nuk bënë tjetër veçse rrënuan trashëgiminë e pasur të Gjykatës Kushtetuese në lëmin e krijimit të një shteti të ri të bazuar në sundimit të ligjit, trashëgimi që ishte krijuar që nga rënia e komunizmit. Këtë e kishte theksuar qartë **Komisoni i Venecias.**[57] Kjo binte ndesh edhe më vendimet e mëparshme të **GJKHu**, të cilat theksonin se interpretimet e mëparshme mund dhe duhej të shërbenin si bazë e punës së saj, në veçanti kur flitet për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, vlerat themelore, institucionet kushtetuese, si dhe interpretimet tjera të cilat kishin

---

54 Cf. Opinion No. 720 / 2013 (CDL-AD(2013)012) of the *EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION)*, the "OPINION ON THE FOURTH AMENDMENT TO THE FUNDAMENTAL LAW OF HUNGARY", adopted by the Venice Commission at its 95th Plenary Session (Venice, 14-15 June 2013) on the basis of comments by Mr. Christoph GRABENWARTER (Member, Austria) Mr. Wolfgang HOFFMANN-RIEM (Member, Germany) Ms. Hanna SUCHOCKA (Member, Poland) Mr. Kaarlo TUORI (Member, Finland) Mr. Jan VELAERS (Member, Belgium).

55 Ky proces i rrënimit të autonomisë së Gjykatës Kushtetuese ka nisur në vitin 2010, kur ky gardian i Kushtetutës së Hungarisë anuloi një ligj mbi taksat speciale. Cf. më shumë lidhur me origjinën e rrënimit të autonomisë së kësaj Gjykate në Gábor Halmai, "Unconstitutional Constitutional Amendments: Constitutional Courts as Guardians of the Constitution?" *Constellations* Volume 19 No 2 (2012) fq. 182-203 fq. 191-199.

56 Cf. Opinion No. 621 / 2011 (CDL-AD(2011)016) of the *EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION)*, the "OPINION ON THE NEW CONSTITUTION OF HUNGARY", adopted by the *Venice Commission* at its 87th Plenary Session (Venice, 17-18 June 2011) on the basis of comments by Mr. Christoph GRABENËARTER (Member, Austria) Mr. Wolfgang HOFFMANN-RIEM (Member, Germany) Ms Hanna SUCHOCKA (Member, Poland) Mr. Kaarlo TUORI (Member, Finland) and Mr. Jan VELAERS (Member, Belgium).

57 Cf. Opinion No. 720 / 2013 (CDL-AD(2013)012) of the *EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION)*, para. 36.

hapur rrugën për krijimin e një shtetit që sundohet nga kushtetuta dhe ligji.[58] Me këtë amendament u bë shkëputja me përvojën dhe traditën kushtetuese të nisur pas rënies së Komunizmit dhe atë të bazuar në interpretimet e Kushtetutës së vitit 2011, gjë që nënkupton cenim të parimit të sundimit të ligjit, ulje të dukshme të nivelit të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive njerëzore, rrënim të reputacionit dhe të pavarësisë në vendimmarrje të Gjykatës Kushtetuese.

Një kohë të gjatë, **GJKHu** kishte konsideruar se nuk duhej të bënte kontrollin e kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese sepse nuk dëshironte të ndërhynte në autonominë e Parlamentit. Kjo gjë më vonë ndryshoi në dhjetor të vitit 2012, kur Gjykata bëri kontrollin kushtetues të dispozitave të Kushtetutës së vitit 2011 që kishin të bënin me dispozitat kalimtare. Me këtë rast, Gjykata dha verdiktin që thoshte se në disa raste ajo mund ta vlerësonte kushtetutshmërinë substanciale (materiale) të amendamenteve kushtetuese për të parë nëse ato ishin në pajtim me kriteret kushtetuese, garancitë dhe vlerat e një shteti demokratik që bazohet në sundim të ligjit.[59] Në kundërshtim me këtë vendim, në fakt si reagim për të shfuqizuar të njëjtin, Parlamenti në amendamentin e katërt futi një dispozitë, dispozitën e nenit 12 (3), e cila amendamentoi dispozitën e nenit të mëparshëm 24 (5) të Kushtetutës. Neni 12 (3) në mënyrë shprehimore ia ndalon Gjykatës Kushtetuese ushtrimin e kontrollit substancial (material) të kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese. Një kontroll të tillë, Gjykata mund ta bëjë tani e tutje vetëm sa i përket aspekteve procedurale që kanë të bëjnë me miratimin dhe shpalljen e amendamentit kushtetues dhe asnjëherë lidhur me substancën (materien) e tij. Kjo praktikisht nënkupton se Kushtetuta e Hungarisë, aktualisht në fuqi, mund të amendamentohet sipas nevojave të politikës ditore me supozim që ekziston një shumicë prej dy të tretave që dëshiron një gjë të tillë. Kjo sepse Gjykata më nuk ka asnjë ingerencë për të kontrolluar aspektet substanciale (materiale) të kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese.

Krejt në fund, neni 17 i amendamentit të katërt në **Kushtetutën e Hungarisë** të vitit 2011, kufizon në mënyrë permanente kompetencën e Gjykatës në lëmin e kontrollit kushtetues substancial (material) të ligjeve që kanë të bëjnë me buxhetin dhe çështjet buxhetore. Kufizimet e tilla kishin nisur më 2010, kur ishin bërë amendamentet në Kushtetutën e vitit 1949. Si reagim ndaj aktivizimit gjyqësor të Gjykatës Kushtetuese ishte futur neni 37 (4), i cili ia mohonte asaj të drejtën për kontroll kushtetues të ligjeve nëse borxhi shtetëror kalonte gjysmën e bruto-produktit shoqëror. Kjo ishte bërë si pasojë e një vendimi të mëhershëm të kësaj gjykate me të cilën kishte shfuqizuar një ligj që fuste një taksë speciale mbi 98 për qind ndaj disa ardhurave të veçanta. Ky kufizim ishte kritikuar ashpër nga **Komisioni i Venecias** në opinionin e tij të dhënë lidhur me Kushtetutën e re të Hungarisë të vitit 2011 (në fuqi nga 1 janari 2012)[60], kurse në opinionin lidhur me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese kishte shprehur keqardhjen për këtë kufizim të kompetencës së Gjykatës Kushtetuese në çështjet buxhetore. Komisioni kishte theksuar shqetësimin e madh sepse tani jo vetëm që përjashtoheshin nga kontrolli kushtetues ligjet buxhetore deri sa borxhi të binte nën 50 për qind të bruto produktit shoqëror, por përjashtohej në tërësi nga kontrolli edhe çdo ligj i miratuar në kohën e "tranzicionit" edhe nëse borxhi binte nën 50 për qind të bruto produktit shoqëror. Me këtë kufizim, situata transitore bëhej permanente.[61]

---

58 Cf. *Decision 22/2012 (V. 11.) of the Constitutional Court of Hungary, Reasoning [40]-[41].*

59 Cf. *Decision 45/2012. (XII. 29.) of the Constitutional Court of Hungary , Reasoning [117]-[118].*

60 Cf. Opinion No. 621 / 2011 (CDL-AD(2011)016) of the *EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION)*, para. 98.

61 Cf. Opinion No. 665 / 2012 (CDL-AD(2012)009) of the *EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION)*, the "OPINION ON ACT CLI OF 2011 ON THE CONSTITUTIONAL COURT OF HUNGARY", adopted by the Venice Commission at its 91st Plenary Session (Venice, 15-16 June 2012) on the basis of comments by Mr. Christoph GRABENWARTER (Member, Austria) Mr. Wolfgang HOFFMANN-RIEM (Member, Germany) Mr. Guido NEPPI MODONA (Substitute Member, Italy). Para. 38.

Polonia, pas ish-Jugosllavisë, paraqet vendin e dytë komunist në të cilin është bërë themelimi i një gjykate kushtetuese sipas modelit **kelsenian/evropian**. Ky themelim u mundësua falë ndryshimeve kushtetuese të vitit 1982. Me këto ndryshime u shtua neni 33a ["Tribunalet dhe Institucionet Tjera'] në **Kushtetutën e Polonisë** të vitit 1952.[62] Sipas paragrafit të fundit të këtij neni, paragrafit 6, juridiksioni, procedura dhe organizimi i Tribunalit Kushtetues do të përcaktohej me ligj të veçantë. Ky ligj u miratua vetëm tri vite më vonë, më 29 prill 1985.[63] Përfundimisht, **Tribunali Kushtetues i Polonisë** (TKPol) filloi të operojë në janar të vitit në vijim. Themelimi i kësaj gjykate asnjëherë nuk nënkuptonte se komunistët polakë kishin ndarë pushtetin me institucionin e ri: roli udhëheqës dhe parësor i partisë komuniste në jetën polake me Dhomën Përfaqësuese (**Sejm**) si organin kryesor të pushtetit, i cili pushtet ishte një dhe i pandashëm, ngeli në fuqi. Themelimi i tij ishte rezultat e një presioni publik dhe i koncesioneve komuniste ndaj këtij presioni, jo si rezultat i ndonjë përpjekje të sinqertë të nomenklaturës polake për transformim të pushtetit dhe ndarje të tij me akterët tjerë të shoqërisë.[64] Kjo qasje u reflektua në nenin e sipërckur 33a, paragrafi i dytë i të cilit i jepte të drejtë Dhomës së Përfaqësuesve (**Sejm**) që të rishqyrtonte vendimet e Tribunalit Kushtetues lidhur me jo kushtetutshmërinë e ligjeve. Kjo nuk vlente për aktet nënligjore, të cilat kishin efekt të menjëhershëm **erga omnes,** thuhej në paragrafin e tretë të nenin 33a si më sipër. Dhoma e Përfaqësuesve (**Sejm**) me shumicën e dy të tretave mund ta rrëzonte vendimin e **TKPol** lidhur kushtetutshmërinë e ndonjë ligji.

Me ndryshimet e vitit 1992, përkatësisht me nxjerrjen e **Kushtetutës së Vogël,** si rezultat i bisedimeve në kuadër të **tryezës së rrumbullakët** të vitit 1989, të cilat sollën ndryshimin paqësor të regjimit komunist në **Poloni**,[65] u bë ndryshimi dhe rritja e kompetencave të Tribunalit Kushtetues. Këto ndryshime i dhanë të drejtën **TKPol** për të dhënë interpretime të detyrueshme të ligjeve si dhe të drejtën për ta bërë kontrollin paraprak të ligjeve sipas kërkesës së Presidentit. **TKPol**, nisur nga këto ndryshime në infrastrukturën kushtetuese dhe ligjore, u imponua si një institucion mjaft aktiv, duke rritur kontrollin kushtetues të aktivitetit të organit legjislativ polak: nga viti 1986 deri në vitin 1988 kishte bërë kontrollin kushtetues vetëm të një ligji polak, nga viti 1989-1991 të trembëdhjetë ligjeve, numër që kaloi në njëzet ligje vetëm gjatë vitit 1993.[66]

Sipas **Kushtetutës së Vogël**, Tribunali nuk mund të bënte kontrollin e konvencionalitetit të legjislacionit vendor, përkatësisht vlerësimin e pajtueshmërisë së legjislacionit polak me marrëveshjet ndërkombëtare të Polonisë. Tribunali po ashtu nuk kishte mundësi që të vendoste lidhur me ankesat kushtetuese të qytetarëve. Vetëm me nxjerrjen e Kushtetutës së vitit 1997, Tribunali u vu në këmbë të barabarta me simotrat evropiane. Kjo gjendje, pra kjo mangësi në kompetencat e tij vinte si pasojë e natyrës së përkohshme të **Kushtetutës së Vogël**. Draftuesit e saj kishin thënë se ai nuk mund të ishte

---

62 **Kushtetuta e Polonisë,** aktualisht në fuqi, është nxjerrë në vitin 1997. Me këtë kushtetutë u zëvendësua Kushtetuta e vitit 1952 e cila modelohej sipas **Kushtetutës së ish-Bashkimit Sovjetik** të vitit 1936 (ish-Jugosllavia i ka pasur të modeluara të gjitha kushtetutat e saj pas Luftës së Dytë Botërore, Përveç Kushtetutës së vitit 1974, sipas kësaj kushtetute sovjetike).
Kushtetuta e Polonisë e vitit 1952 ka qenë amendamentuar disa herë pas ndryshimeve në regjimin politik dhe kushtetues polake. Amendamentimi më i njohur është ai i vitit 1992, kur është nxjerrë **Ligji Kushtetues mbi Marrëdhëniet Reciproke në mes të Institucioneve Legjislative dhe Ekzekutive të Republikës së Polonisë dhe mbi Qeverisjen Lokale** i datës 17 tetor 1992. Ky ligj në literaturë njihet si **Kushtetuta e Vogël**.

63 Act of 29 April 1985 on the Constitutional Tribunal amended by the Constitutional Act of 1 August 1997.

64 Për historinë dhe motivet e themelimit të **Tribunalit Kushtetutës të Polonisë**, shih më shumë në : Mark Brzeziński, "The Emergence of Judicial Review in Eastern Europe: The Case of Poland." *The American Journal of Comparative Law* Vol. 41 No. 1 (Winter 1993); Rett R. Ludwikowski, "Constitution Making in the Countries of Former Soviet Dominance: Current Development." *Georgia Journal of International and Comparative Law* Vol. 23 No. 2 (1993); Mark F. Brzezinski, Leszek Garlicki, "Judicial Review in Post-Communist Poland: The Emergence of a Rechtsstaat?," *Stanford Journal of International Law Vol.* 31 No. 1 (1995).

65 Brain Porter, "The 1989 Polish Round Table Revisited: Making History." *The Journal of the International Institute* Volume 6, Issue 3 (Summer 1999). Burim në internet: https://quod.lib.umich.edu/j/jii/4750978.0006.301/--1989-polish-round-table-revisited-making-history?rgn=main;view=fulltext (kontrolluar në prill 2017).

66 Mark F. Brzezinski, Leszek Garlicki, "Judicial Review in Post-Communist Poland: The Emergence of a Rechtsstaat?," fq. 59.

interpretues i një dokumenti të përkohshëm, përkatësisht se një kompetencë e tillë e plotë mund t'i jepej **TKPol** vetëm pas nxjerrjes së dokumentit të vërtetë dhe të plotë kushtetues.[67] Kjo ndodhi në vitin 1997, kur u nxor **Kushtetuta e Polonisë**, aktualisht në fuqi. Autorizimet e tij me këtë hap u zgjeruan dukshëm dhe u bënë të njëjta më gjykatat kushtetuese të vendeve ish-komuniste të Evropës. Ndër kompetencat e reja ishin ato që kishin të bënin me marrëveshjet ndërkombëtare dhe kushtetutshmërinë e partive politike,[68] si dhe me ankesat kushtetuese si mjet për mbrojtjet e të drejtave dhe lirive individuale.[69] Po ashtu, ndryshoi edhe natyra e vendimeve të Tribunalit, të cilat tani ishin me efekt **erga omnes** dhe nuk mund të sfidoheshin në asnjë instancë dhe nga asnjë organ i pushtetit në Poloni. Me këto ndryshime, rendi kushtetues i përkohshëm u bë i përhershëm dhe institucioni i Tribunalit tani e tutje kishte një kushtetutë të vërtetë, të cilën duhej ta interpretonte me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së dispozitave të saj.

Gjykata Kushtetuese e Çekosllovakisë (GJKÇK**)** sikundër është diskutuar në kapitujt pararendës, daton që nga vitit 1920. Për dallim nga **Gjykata Kushtetuese e Austrisë (GJKAu)**, e themeluar po ashtu më 1920, **GJKÇK** nuk arriti të rikrijohet në vitin 1945. Pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, Çekosllovakia ra nën sundimin komunist. Lufta për themelimin e një gjykate kushtetuese u bë në këtë mënyrë pjesë e luftës së popullit çekosllovak për liri dhe pavarësi nga ndikimi sovjetik. Gjatë lëvizjeve për liri dhe kundër sundimit komunist sovjetik, më 1968, për herë të parë u mendua seriozisht që të krijohet një gjykatë kushtetuese sipas modelit që kishte ekzistuar para Luftës së Dytë Botërore, si pjesë e ndryshimeve liberale kushtetuese që synoheshin në këtë vend dhe në atë kohë. Megjithatë, themelimi i saj ndodhi vetëm pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, jo më herët, për arsye krejtësisht tjera.

Themelimi i **GJKÇK** nuk duhej të ishte restaurim i gjykatës së para Luftës së Dytë Botërore, e aq më pak implementim i idesë së komunistëve çekosllovakë të vitit 1968, të cilët synuan themelimin e një institucioni që do të ishte një kompromis i kohës dhe që, në esencë, synonte shpërbërjen e idesë komuniste mbi unitetin e pushtetit por me një qasje dhelpërake të atyre që e synonin. Për këtë arsye asnjëherë nuk u realizua në praktikë dhe ngeli si një ide e mirë në historinë e gjyqësisë kushtetuese të këtij vendi sepse binte ndesh me parimet bazë të sistemit komunist mbi natyrën e pushtetit dhe bartësit e tij[70]. Sipas ndryshimeve kushtetuese të vitit 1968, të cilat mundësonin themelimin e **GJKÇK**, parashikohej edhe themelimi i gjykatave kushtetuese në dy republikat federale, Çekia dhe Sllovakia. Kjo nënkuptonte se gjyqësia kushtetuese çekosllovake mendohej të kishte fizionomi të njëjtë me gjyqësinë kushtetuese jugosllave: Gjykata Kushtetuese Federale do të kishte për detyrë mbrojtjen e kushtetutës dhe ligjeve federale, kurse ato të republikave konstitutive do të mbronin kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë në nivel republikan.[71]

---

67 Radoslav Prochazka, *Mission Accomplished . On Founding Constitutional Adjudication in Central Europe* (CEU Press: Budapest: 2002) fq. 37-39.

68 Neni 188 ["Tribunali Kushtetues"] i Kushtetutës thekson se Tribunali ka kompetencë për të gjykuar për si vijon: ".1. pajtueshmërinë e ligjeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën; 2. pajtueshmërinë e ligjit me marrëveshjet ndërkombëtare ratifikimi i të cilave kërkon pëlqimin paraprak të shprehur me ligj; 3. pajtueshmërinë e dispozitave juridike të lëshuara nga organet qendrore shtetërore me Kushtetutën, marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare dhe ligjet; 4. pajtueshmërinë me Kushtetutën të qëllimeve dhe aktiviteteve të partive politike; 5. ankesat kushtetuese lidhur me cenimet kushtetuese të parashikuara në nenin 79 paragrafi 1 të Kushtetutës".

69 Neni 79.1 ["Mjetet për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave"] i Kushtetutës përcakton se: "Në pajtim me parimet e përcaktuara me ligj, çdokujt që iu janë cenuar të drejtat dhe liritë kushtetuese ka të drejtën e ankesës në Tribunalin Kushtetues me qëllim të marrjes së një aktigjimi lidhur me pajtueshmërinë me Kushtetutën të ligjit apo ndonjë akti tjetër normativ mbi të cilin mbështetet vendimi i gjykatës apo i ndonjë organi administrativ lidhur me të drejtat dhe liritë e tij apo detyrimet ashtu siç janë përcaktuar me kushtetutë".

70 Darina Malova, "The Role and Expoerience of the Slovakian Constitutional Court". Në Wojciech Sadurski (ed.), Constitutional Justice , East and West. Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comnparative Perspective (Kluwer Law International: The Hague, 2010) fq. 349-372 në fq. 351-352; Jiri Priban, "Judicial Power vs. Democratic Representation: The Culture of Constitutionalism and Human Rights in the Czech Legal System". Në Ibid. fq. 373-394 në. fq. 374-375.

71 Dimitrije Kulic, *USTAVNO SUDSTVO U SVETU* ("Nasa Rec": Leskovac, 1972) fq. 190-194.

Themelimi i gjyqësisë kushtetuese në Çekosllovaki përfundimisht ka ndodhur shumë më pastaj, pas rënies së **Murit të Berlinit** dhe kolapsit të sistemit komunist në Evropë. Dy janë arsyet kryesore që kanë çuar në themelimin e **GJKÇK**, njëra është klasike ashtu siç është konceptuar nga arkitekti ideor i gjyqësisë kushtetuese, **Hans Kelsen**, kurse arsyeja tjetër ka natyrë krejt moderne dhe lidhet me implementimin e dispozitave kushtetuese të cilat i referohen lirive dhe të drejtave njerëzore.[72]

Në vijim si më sipër, **arsyeja e parë**, sikundër mund të vetëkuptohet, ka të bëjë me **federalizmin**, përkatësisht me vetë arsyen pse ka lindur modeli **evropian/kelzenian** i gjyqësisë kushtetuese. Jo vetëm kaq! Kontrolli gjyqësor i legjitimitetit kushtetues të ligjeve ka në themel të tij ruajtjen e supremaicsë (epërsisë) së Kushtetutës në një kontekst federal. Kjo qartë vërtetohet nëse analizohet historiku i lindjes së gjyqësisë kushtetuese në **SHBA**, para dhe pas rastit **Marbury v. Madison** (1803), si dhe funksioni parësor i kësaj gjyqësie në kohën e lindjes së saj dhe më pastaj.

Futja e të drejtave dhe lirive njerëzore në tekstin kushtetues, një trend ky që ka nisur me **Kushtetutën e Vajmarit**, u bë një **condiction sine qua non** e konstituticionalizmit pas Luftës së Dytë Botërore. Këtë e bënë si vendet e ish-lindjes komuniste ashtu dhe vendet e demokracive kushtetuese liberale. Pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, të gjitha vendet ish-komuniste me një zell të pashoq futën në kushtetutat e tyre të reja dispozitat mbi liritë dhe të drejtat njerëzore dhe ofruan garancione dhe mekanizma për vënien në jetë të tyre. Çekosllovakia qe vendi i parë ndër vendet komuniste që futi në amendamentimet e Kushtetutës së vitit 1960 dispozita të detajuara mbi të drejtat dhe liritë njerëzore. Kjo përbën **arsyen e dytë,** krejtësisht të kundërt me vetë konceptin evropian/kelzenian të gjyqësisë kushtetuese, e cila rri prapa idesë mbi themelimin e **GJKÇK pas** rënies së **Murit të Berlinit**.

Sikundër dihet, vetë **Hans Kelsen** ka qenë me tërë qenien kundër implementimit gjyqësor përmes gjykatës kushtetuese të dispozitave kushtetuese mbi të drejtat e njeriut. Në fakt, ai këtë funksion të gjyqësisë kushtetuese as që ka mund ta paramendojë, pikërisht si pasojë e faktit se kundërshtarët e gjyqësisë kushtetuese, si puna e **Karl Shmit** dhe tjerëve, i kanë parë dispozitat mbi të drejtat dhe liritë e njeriut si dispozita subversive dhe si një "kolonë e pestë" brenda tekstit kushtetues apo, siç e ka thënë **Karl Shmit**, si një "kushtetutë të dytë". Sipas tyre, këto dispozita pengojnë realizimin e rendit të përcaktuar me kushtetutë. Kjo pikëpamje për kohën e ka trembur edhe vetë arkitektin e gjyqësisë kushtetuese evropiane, **Hans Kelsen**, i cili çdoherë ka insistuar se vetëm funksioni i ligjvënësit negativ mund të ushtrohet nga ana e gjykatave kushtetuese, asgjë tjetër. Kjo ka qenë e kuptueshme për kohën, nisur nga fakti se në atë kohë ka mbretëruar koncepti hegelian mbi shtetin si kujdestar absolut i mirëqenies së individit dhe mbi rolin zero që individi e luan në një shoqëri të organizuar në shtet. Në këtë kuadër, mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut duhet të ngelë, gjithnjë sipas pikëpamjes së kohës kur lindi ideja e gjyqësisë kushtetuese evropiane, prerogativë e gjykatave të rregullta dhe e organeve tjera.

Në aspektin formal, Çekosllovakia ka qenë vendi i parë ish-komunist evropian që ka parashikuar institucionin e kontrollit kushtetues përmes krijimit të një gjykate të ndarë dhe të veçantë kushtetuese sipas modelit evropian/kelzenian. Deri në nëntor të vitit 1991, megjithatë, nuk u nxor **Ligji i Çekosllovakisë mbi Gjykatën Kushtetuese**, kurse gjyqtarët e parë të Gjykatës Kushtetuese të Çekosllovakisë u emëruan në janar 1992. Gjykata kishte kompetencën të vendosë lidhur me pajtueshmërinë e ligjeve federale me Kushtetutën, si dhe pajtueshmërinë e akteve kushtetuese dhe ligjore të Çekosllovakisë me marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut. Gjykata po ashtu ishte kompetente për të vendosur

[72] Në shtator të vitit 1990, grupe të ekspertëve të Çekosllovakisë nisën punën për amendamentimin e Kushtetutës së Çekosllovakisë të vitit 1960, e cila më 1968 ishte amendamentuar fuqishëm por që atëherë nuk arriti t'i fusë në gjirin e vet dispozitat mbi Gjykatën Kushtetuese. Liderët e vendit vendosën që, megjithatë disa dispozita kushtetuese të kishin përparësi ndaj tjerave dhe të miratoheshin më herët. Këto dispozita të cilat u miratuan më herët kishin të bënin me këto tri çështje: e para, dispozitat mbi federalizmin, pra mbi marrëdhëniet ndërmjet dy republikave përbërëse të këtij shteti (Çekisë dhe Sllovakisë); e dyta , dispozitat mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, të cilat në këtë vend aq shumë ishin mohuar në kohën e sundimit sovjetik komunist; dhe, së fundi, dispozitat lidhur me gjykatën e re kushtetuese . Cf. Lloyd Cutler and Herman Schwartz, "Constitutional Reform in Czechoslovakia: E Duobus Unum? " *The University of Chicago Law Review* Vol. 58, No. 2 (1991) fq. 521-522; Radoslav Prochazka, *Mission Accomplished,* fq. 61-62.

lidhur interpretimin abstrakt të Kushtetutës dhe mbi ankesat individuale për cenimin e të drejtave dhe lirive njerëzore të garantuara me Kushtetutë apo me marrëveshje të ratifikuara ndërkombëtare mbi të drejtat dhe liritë e njeriut.[73] Gjykata, megjithatë, zgjati vetëm njëmbëdhjetë muaj dhe pati rastin që të vendosë meritorisht shumë pak raste. Roli i saj në zhurmën dhe kaosin politik e institucional të viteve 1991-1992 ka qenë mjaft periferik. Dëshira për t'u ndarë në mes të shteteve anëtare të **Federatës së Çekosllovakisë** u provua më e fortë se konstitucionalizmi i bazuar në federalizëm simetrik në mes dy shteteve. Në pikëpamje të zhvillimit kushtetues, megjithatë, vlen të theksohet fuqishëm se shpërbërja paqësore e Çekosllovakisë dhe krijimi i dy shteteve të reja, Çekisë dhe **Sllovakisë**, paraqet një progres. **Sllovakia** miratoi kushtetutën e vet, aktualisht në fuqi, në shtator të vitit 1992, kurse Çekia tre muaj më vonë. Dy shtetet, vitin në vijim, më 1993, themeluan gjykatat e tyre kushtetuese.

Me amendamentet kushtetuese të vitit 2001, në **Kushtetutën e Sllovakisë** të vitit 1992, Gjykata Kushtetuese ka fituar kompetenca shtesë.[74] Juridiksioni dhe palët e autorizuara janë të rregulluara me nenet 124–140 të Kapitullit të Shtatë, seksioni i parë ["Pushteti Gjyqësor"] të Kushtetutës. Në Sllovaki, pra, Gjykata Kushtetuese bën pjesë në dispozitat kushtetuese mbi pushtetin gjyqësor. Kjo konstatohet në mënyrë shprehimore në nenin 124, i cili e definon **Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Sllovakisë** (GJKSlk) si "[...] një autoritet të pavarur gjyqësor i veshur me mandat për të mbrojtur kushtetutshmërinë". Seksioni i dytë i Kapitullit të Shtatë flet për gjykatat e **Republikës së Sllovakisë**, me kuptim gjykatat e rregullta. Pra, në të njëjtin kapitull me gjykatat e rregullta të këtij vendi rregullohet roli dhe pozita e Gjykatës Kushtetuese, kurse procedura dhe organizimi i saj rregullohen me **Ligjin Nr. 38/1993 mbi Organizimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Sllovakisë.**

GJKSlk, sipas kushteve jashtëzakonisht të komplikuara lidhur me zotësinë për të qenë palë në procedurën pranë saj, ka të drejtën e kontrollit të legjitimitetit kushtetues të çdo legjislacioni si dhe kontrollin e pajtueshmërisë së legjislacionit të nivelit të ulët me legjislacionin nivelit më të lartë. Përveç kësaj, Gjykata ka kompetencë për të vendosur edhe për kontrollin represiv dhe preventiv të marrëveshjeve ndërkombëtare, pra si për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare, ashtu edhe për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të marrëveshjeve të negociuara, por ende të paratifikuara nga parlamenti sllovak, të marrëveshjeve ndërkombëtare. Këto kompetenca parashihen me nenet 125 dhe 125a të Kushtetutës.

Përveç sa më sipër, sipas nenit 127 të Kushtetutës, **GJKSlk** ka kompetencë për të vendosur edhe për anekset kushtetuese lidhur me cenimet e të drejtave dhe lirive kushtetuese nga ana e autoriteteve publike, përfshirë këtu gjykatat e rregullta, me kusht që palët t'i kenë shterur të gjitha mjetet tjera juridike.

Ajo po ashtu, sipas neneve 127a dhe 129 vendos edhe lidhur me:

- mbrojtjen e të drejtave të vetëqeverisjes lokale të njësive administrativo-territoriale dhe kompetencave të tyre;
- kushtetutshmërinë e referendumit;
- kushtetutshmërinë e zgjedhjeve për parlament si dhe për ato që kanë të bëjnë me parlamentin dhe me organet e vetëqeverisjes lokale;
- kushtetutshmërinë e shpërbërjes së partive politike apo suspendimin e punës së tyre;
- cenimet e qëllimshme të Kushtetutës nga ana e Presidentit; dhe, së fundi;
- kushtetutshmërinë e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme.

Në nenin 128 të Kushtetutës përcaktohet një kompetencë e rrallë e **GJKSlk** : e drejta e saj për të interpretuar Kushtetutën në çështjet që janë të kontestueshme. Aktgjykimet në këto raste kanë karakter interpretues këshillues për organet të cilat kërkojnë interpretimet e tilla. Interpretimi i këtij lloji bëhet

---

73 Lloyd Cutler and Herman Schwartz, "Constitutional Reform in Czechoslovakia: E Duobus Unum?", fq. 541-542.

74 *Constitution of the Slovak Republic: No. 460/1992 Coll., as amended by the constitutional acts No. 244/1998 Coll., No. 9/1999 Coll. and No. 90/2001 Coll*. (Bratislava: Office of the National Council of the Slovak Republic, 2001) .

ndaras nga dispozitat tjera apo mosmarrëveshjet konkrete kushtetuese ku ka palë që legjitimohen si pasojë e pasjes së një interesi të veçantë juridiko-kushtetues. Thënë shkurt, me këto aktgjykime, norma kushtetuese interpretohet duke e krahasuar atë me vetveten dhe me normat tjera kushtetuese, me shpirtin dhe frymën e tyre të marra si një tërësi e vetme kushtetuese, përfshirë këtu edhe krahasimin e tyre me praktikat më të mira të konstitucionalizmit të botës bashkëkohore.

Gjykata Kushtetuese e Çekisë (GJKÇe), njëjtë si në rastin sllovak, bën pjesë në dispozitat që flasin për gjyqësorin çek. Këto dispozita gjenden në nenet 83-89 të kapitullit të IV-të [„Pushteti Gjyqësor"] të Kushtetutës së vitit 1993, e cila ende është në fuqi me amendamentet e mëvonshme[75]. Procedura për vënien në lëvizje si dhe vetë organizimi i Gjykatës përcaktohet me **Ligjin nr. 182/1993 mbi Gjykatën Kushtetuese**.[76]

Sipas nenit 83 të Kushtetutës, Gjykata definohet si një trup gjyqësor, i cili është përgjegjës për mbrojtjen e kushtetutshmërisë, kurse kompetencat e saj të përcaktuara në nenin 87 janë shumë të ngjashme me ato të **GJKSlk**. Megjithatë, në mes tyre ekzistojnë tri dallime sa i përket aspektit juridiksional, dy prej të cilave bazohen në tekstin kushtetues, kurse njëri dallim buron nga ndikimi gjerman në gjyqësinë kushtetuese të këtij vendi.

Në rastin çek, në këtë kontekst, **GJKÇe** nuk ka kompetencë për të bërë kontrollin kushtetues represiv të marrëveshjeve ndërkombëtare. Sipas nenit 87 pika 2 të Kushtetutës, kontrolli kushtetutshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare mund të bëhet vetëm para se të ndodhë ratifikimi i tyre kushtetues. Në të njëjtën mënyrë, Kushtetuta nuk e njeh, për dallim nga rasti sllovak, të drejtën e Gjykatës për të dhënë aktgjykim interpretues këshillëdhënës.

Dallimi i fundit, i cili përflitet në literaturë, pra që nuk derivon nga teksti i Kushtetutës, ka të bëjë me aktivizimin gjyqësor të Gjykatës së Çekisë në lëmin e te drejtave dhe lirive të garantuara kushtetuese. Ky aktivizëm e bën këtë gjykatë të dallojë nga ajo sllovake. Kjo si pasojë e ndikimit të madh të gjyqësisë kushtetuese gjermane në **GJKÇe**, në veçanti sa i përket zbatimit të modelit gjerman mbi **efektin rrezatues** të të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutë. Sipas kësaj praktike gjermane, të cilën fuqishëm e zbaton **GJKÇe,** gjykatat e rregullta urdhërohen që të drejtat dhe liritë njerëzore të shkruara në tekstin kushtetues mos t'i shohin vetëm si një katalog mekanik që vihet në jetë **ad literam** dhe në mënyrë mekanike dhe krejtësisht dogmatike ashtu siç janë shkruar. Ky imitim i standardeve gjermane ekziston edhe përkundër faktit që në **Kushtetutën e Çekisë**, në nenin 89, shprehimisht përcaktohet se gjyqtarët e kësaj gjykate janë të detyruar të gjykojnë vetëm sipas rendit kushtetues dhe ligjit.

Gjatë përvojës së saj që nga themelimi, Gjykata ka provuar në mënyrë të përsëritur që të bëjë transplantimin në sistemin kushtetues çek doktrinat dhe përvojat gjermane, përfshirë këtu edhe doktrinën mbi **efektin rrezatues** mbi tërë sistemin juridik-kushtetues çek të të drejtave dhe lirive njerëzore. Ky efekt është cilësuar si ashtuquajturi **efekt i llojit të tretë**, krahas **efektit të drejtpërdrejtë** dhe **efektit horizontal** të të drejtave dhe lirive të njeriut. Sipas efektit rrezatues, disa raste në praktikë rregullohen sipas ligjeve të zakonshme, pra jo sipas dispozitave kushtetuese, mirëpo kanë dimensione të qarta kushtetuese ashtu që gjykatat dhe organet tjera me rastin e vendosjes së këtyre rasteve që normohen me ligje të zakonshme, pra me norma jo kushtetuese, duhet të interpretojnë ligjet e zakonshme duke i marrë parasysh të drejtat dhe liritë e garantuara kushtetuese. Kjo nënkupton se, ta zëmë, me rastin e zbatimit të dispozitave ligjore të **Kodit Civil** lidhur me shpifjen dhe fyerjen, gjykata dhe organi tjetër duhet ta marrin parasysh lirinë e shprehjes dhe ta vlerësojnë dhe balancojnë këtë liri kundrejt të drejtave tjera të personalitetit, siç është e

---

75 *Constitution of the Czech Republic of 1993 with Amendments through 2013.* Burim në internet: constitutionproject.org (shikuar në prill të vitit 2917).

76 *Constitutional Court Act No. 182/1993 of 16 June 1993 as amended by Acts No. 31/1993 Sb., 236/1995 Sb., 77/1998 Sb., 18/2000 Sb., 132/2000 Sb., 48/2002 Sb., 202/2002 Sb., 320/2002 Sb., 114/2003 Sb., 83/2004 Sb., 120/2004 Sb., 234/2006 Sb., 342/2006 Sb., 227/2009 Sb. 404/2012 Sb., and 275/2012 Sb.* Burim interneti: http://www.usoud.cz/en/legal-basis/ (shikuar në prill të vitit 2017).

drejta e respektimit të nderit të personit. Injorimi i këtij aspekti kushtetues me rastin e zbatimit të ligjit të zakonshëm, përkatësisht konfliktin e të drejtave në marrëdhëniet horizontale në mes të individëve, do të shpinte në një praktikë gjyqësore të njëanshme dhe të mangët, e cila praktikë do të minonte në tërësi lirinë e shprehjes në marrëdhëniet private në mes të njerëzve. Këtë pikëpamje gjermane, **GJKÇe**, siç u tha, e zbaton një kohë të gjatë dhe i udhëzon gjykatat e rregullta që ta bëjnë një gjë të tillë.[77]

5.3. Vendet tjera

Këtu diskutohen, sipas rendit alfabetik shqip, **Armenia**, **Bjellorusia, Bullgaria, Gjeorgjia, Moldavia, Rumania, Rusia, Shqipëria**, dhe **Ukraina.** Kjo do të thotë diskutohen vendet e **Evropës Jug-Lindore**, me perjashtim te vendeve ish-jugosllave dhe atyre baltike qe u diskutuan ne kapitullin paraprak. Këtu përjashtohen edhe vendet e **Azisë Qendrore** që diskutohen më vonë në kuadër të diskutimit për **vendet islamike** (arabe dhe joarabe) por edhe vendet tjera të Lindjes së Largët si **Kina, India, Indonezia, Koreja e Jugut, Vietnami, Tajlanda** dhe **Kamboxha,** të cilat gjithashtu diskutohen ndaras më vonë.

Në të gjitha rastet si më sipër, përzgjedhja është bërë në mënyrë të randomizuar dhe pa ndonjë kriter, gjithnjë me shpresën se vendet që diskutohen këtu përbëjnë një model pak a shumë të ngjashëm me vendet tjera përrreth të cilat janë lënë jashtë diskutimit: ta zëmë, **India** pak a shumë paraqet model kushtetues të ngjashëm me **Pakistanin** dhe **Afganistanin**, **Vietnami** me **Kamboxhen**, **Indonezia** me **Korenë e Jugut** dhe **Kina** me **Korenë e Veriut** e kështu me radhë.

Armenia ka një gjykatë kushtetuese që nga viti 1995, me më shumë vonesë krahasuar me vendet tjera të bllokut ish-sovjetik. Historiku i formimit të saj, megjithatë, nis njëjtë si me ish-republikat sovjetike. Në fund të viteve '90 të shekullit të kaluar, më 1988, në nivel të Bashkimit Sovjetik, siç dihet, u formua një trup politik i kontrollit kushtetues, i njohur si **Komiteti i Kontrollit Kushtetues**. Një ligj që rregullonte punën e këtij trupi parashikonte formimin e komiteteve të njëjta në nivel të secilës ish-republikë sovjetike. Kjo gjë, megjithatë, nuk ndodhi si pasojë e shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik dy vjet më vonë.

Pas pavarësimit të Armenisë më 21 shtator 1991, legjislatura e këtij vendi bëri një deklaratë me të cilën zotohej se do të formonte një gjykatë kushtetuese, diçka që ndodhi katër vjet më vonë: me **Kushtetutën e Armenisë** të vitit 1995, e miratuar me referendum, për herë të parë u sanksionua themelimi i **Gjykatës Kushtetuese të Armenisë** (GJKAr). Në renditjen e dispozitave kushtetuese lidhur me Gjykatën ka një rend të çuditshëm: Kushtetuta nuk ka një kapitull të veçantë për **GJKAr**, por flet për të në kuadër të dispozitave të neneve 91-98 të kapitullit 6 ["Pushteti Gjyqësor"], ku kryesisht flitet për ndarjen e drejtësisë nga gjykatat e juridiskionit të përgjithshëm dhe për Këshillin Gjyqësor. Kjo qasje, megjithatë, qartësohet me **Ligjin e Republikës së Armenisë mbi Gjykatën Kushtetuese** të vitit 1995.

Sipas nenit 1.1. [„Gjykata Kushtetuese e Republikës së Armenisë"] të Ligjit, "[...] Gjykata Kushtetuese është trupi më i lartë i drejtësisë kushtetuese që ofron supremacinë (epërsinë) dhe zbatimin e drejtpërdrejtë të Kushtetutës në sistemin juridik të Republikës së Armenisë". Ky nen më shumë se kaq nuk diskutohet në këtë libër meqë nuk përcakton ndonjë jurdiksion shtesë për **GJKAr**, siç është rasti me disa vende tjera ku juridiksioni shtesë mund të përcaktohet me ligj. Kosova bën pjesë në këto vende.

Dispozita si më sipër e nenit 1.1. të Ligjit i bën të qarta dy gjëra. Në rend të parë, nga dispozitat kushtetuese armene nuk vërehet dallimi në mes të ndarjes së drejtësisë që bëhet nga gjyqësori i rregullt dhe gjyqësisë kushtetuese që shqiptohet nga Gjykata Kushtetuese dhe që ka domethënien **evropiane/kelseniane**. Kjo do të thotë se Gjykata Kushtetuese është një trup i ndërmjetëm dhe i ndarë, i cili i kontrollon tri pushtetet tjera shtetërore dhe nuk vihet mbi to në hierarki, por as nuk është pjesë e tyre në aspektin organizativ apo funksional. Për pasojë, në rend të dytë, kjo qartësohet nga vetë dispozitat kushtetuese të nenit 6.1 të kapitullit të parë të Kushtetutës, të cilat flasin për themelet e rendit kushtetues armen. Në këtë dispozitë thuhet

[77] *Zdeněk Kühn*, "The Constitutional Court of the Czechk Republik" . Në András Jakab, Arthur Dyevre and Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* (Cambridge University Press: Cambridge , 2017) fq. 200- 201.

në mënyrë shprehimore dhe pa asnjë ekuivoke se Kushtetuta është ligji me forcë juridike supreme, normat e së cilës zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në tërë **Republikën e Armenisë**. Vetëm përmes një interpretimi të lidhur të këtyre dy palë dispozitave të natyrës kushtetuese dhe ligjore mund të nxjerrët kuptimi i vërtetë i vetë natyrës dhe vendit të **GJKAr** në sistemin kushtetues. Kjo refektohet edhe në dispozitat kushtetuese mbi juridiksionin e saj, të cilat, siç u konstatua, janë të shkapërderdhura në pjesët që flasin në përgjithësi për pushtetin gjyqësor.

Sipas nenit 100 të Kushtetutës, **GJKAr** ka juridiksion, në pajtim më ligjin, për:

- vendosjen nëse janë në pajtim me Kushtetutën: ligjet, vendimet e Kuvendit Nacional, urdhrat dhe dekretet e Presidentit të Republikës sikundër dhe vendimet e Qeverisë;
- vendosjen, para se të ratifikohet një marrëveshje ndërkombëtare, nëse detyrimet e marra me marrëveshjen e tillë ndërkombëtare janë në pajtim me Kushtetutën;
- vendosjen lidhur me kontestet që kanë të bëjnë me referendumet dhe rezultat e zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare;
- konstatimin e ekzistimit të pengesave të pakapërcyeshme me të cilat ndeshet kandidati për President si dhe lidhur me eliminimin e pengesave të tilla;
- përcaktimin nëse ekzistojnë bazat për largim nga posti të Presidentit të Republikës;
- përcaktimin nëse ekzistojnë bazat për zbatimin e seksioneve 13 dhe 14 të nenit 55 të Kushtetutës;[78]
- përcaktimin nëse Presidenti i Republikës është i paaftë për të vazhduar kryerjen e funksioneve të veta;
- përcaktimin nëse ekzistojnë bazat për shkarkimin e një anëtari të Gjykatës Kushtetuese, arrestimin apo nisjen e procedurave administrative apo penale përmes një procesi gjyqësor; dhe, së fundi,
- vendosjen lidhur me pezullimin apo ndalimin e një partie politike në rastet e përcaktuara nga ligji.

Gjykata Kushtetuese e Bjellorusisë (GJKBj) është krijuar më 1994, d.m.th. tri vjet pas fitimit të pavarësisë së këtij vendi. **Kushtetuta e Bjellorusisë** e vitit 1994[79] ka vetëm një nen, nenin 116 [„Gjykatat“] që flet për **GJKBj**. Në paragrafin e parë të këtij neni, ajo përcaktohet si mbrojtës i kushtetutshmërisë së të gjitha akteve legjislative shtetërore. Dy paragrafët në vijim flasin për përbërjen e saj dhe mënyrën e zgjedhjes së gjyqtarëve. I katërti paragraf flet për juridiksionin dhe palët e autorizuara. Në juridiksion të **GJKBj** janë:

- vendosja mbi pajtueshmërinë e ligjeve, dekreteve dhe urdhëresave të Presidentit, marrëveshjeve ndërkombëtare dhe detyrimeve tjera me Kushtetutën dhe instrumentet tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Bjellorusisë;
- vendosjen për pajtueshmërinë e instrumenteve të formacioneve ndërshtetërore, ku është pjesë Republika e Bjellorusisë dhe urdhrave të Presidentit të lëshuara në vijim të zbatimit të ligjeve me Kushtetutën, ligjet, dekretet dhe me instrumentet e ratifikuara të së drejtës ndërkombëtare;
- vendosjen për pajtueshmërinë e vendimeve të Këshillit të Ministrave dhe urdhrave të Gjykatës Supreme, Gjykatës Supreme Ekonomike dhe të Prokurorit të Përgjithshëm më Kushtetutën, ligjet dhe instrumentet e ratifikuara të së drejtës ndërkombëtare;
- vendosja për pajtueshmërinë e akteve juridike të secilit trup shtetëror me Kushtetutën, ligjet, dekretet dhe ligjet dhe instrumentet ndërkombëtare të ratifikuara nga ana e Republikës së Bjellorusisë.

---

78 Sipas nenit 55 [“Presidenti i Republikës”] të Kushtetutës, Presidenti i Republikës së Armenisë, **inter alia**, ka këto kompetenca: “[...] 13. në rast sulmi të armatosur apo të rrezikut imanent ndaj Republikës si dhe në rast të shpalljes së luftës nga Kuvendi Nacional, Presidenti bën shpalljen e gjendjes së shtetrrethimit dhe mund të bëjë thirrje për mobilizim të pjesshëm apo të përgjithshëm. Me rastin e shpalljes së gjendjes së shtetrrethimit mbahet një mbledhje e veçantë e Kuvendit Nacional ; 14. në rast rreziku të menjëhershëm ndaj rendit kushtetues, pas konsultimeve me Presidentin e Kuvendit Nacional dhe Kryeministrin, ndërmerr masat përkatëse me situatën dhe i adresohet popullit lidhur me situatën”.

79 *The Constitution of Belarus of 1994 with Amendments through 2004. Burim në internet:* https://www.Constitute project.org/constitution/Belarus_2004.pdf?lang=en (shikuar në prill 2017).

Në paragrafin e parafundit përcaktohet një kompetencë e veçantë dhe krejt specifike për kushtet e këtij vendi, sipas të cilës me kërkesë të Presidentit të Republikës, **GJKBj** duhet të japë vendim lidhur me shkeljet flagrante, siç thuhet, të Kushtetutës nga ana e dy dhomave të Parlamentit. Kushtetuta nuk përcakton se çfarë janë pasojat e një vendimi të tillë, mirëpo mund të supozohet se një vendim i tillë i **GJKBj** ku konstatohet shkelja flagrante e Kushtetutës nënkupton anulimin e vendimeve të tilla të dy dhomave të Parlamentit.

Kushtetuta e Bjellorusisë nuk e njeh ankesën kushtetuese. Si palë të autorizuara paraqiten vetëm organet qendrore, pra si subjekte të privilegjuara që nuk kanë nevojë të provojnë ekzistimin e interesit të tyre juridik dhe kushtetues për të qenë palë në procedurë pranë Gjykatës Kushtetuese.

Organizimi dhe procedura pranë Gjykatës rregullohet me ligj të veçantë, si në shumicën e vendeve të cilat kanë **modelin evropian/kelzenian** të gjyqësisë kushtetuese. Edhe Bjellorusia bën pjesë në këtë model, ani se dispozitat për **GJKBj** gjenden në kuadër të dispozitave kushtetuese mbi gjykatat e këtij vendi. Me rëndësi është që kjo gjykatë ka juridiksion të qartë të përcaktuar kushtetues dhe një ligj të veçantë që normon organizmin dhe punën e saj.[80]

Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë (GJKBu) është po ashtu gjykatë e re, e themeluar më 1991 pas mbarimit të Luftës së Ftohtë dhe rënies së komunizmit. Ajo nuk është pjesë e gjyqësorit të rregullt bullgar, por një trup i ndarë nga ai, me kompetenca dhe autorizime të qarta kushtetuese. **Kushtetuta e Bullgarisë** e vitit 1991, aktualisht në fuqi,[81] në kapitullin e tetë [„Gjykata Kushtetuese“] flet për **GJKBu**, palët e autorizuara, juridiksionin dhe për çështje tjera lidhur me caktimin (zgjedhjen) dhe imunitetin e gjyqtarëve, si dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë më të.

Në nenin 149 të Kushtetutës përcaktohet juridiksioni i saj kurse nenin në vijim, neni 150 flet për palët e autorizuara. Në grupin e palëve të autorizuara nuk duket individi, njëjtë si në rastin e Bjellorusisë, pra nuk lejohet ankesa kushtetuese.

Juridiksioni i **GJKBu** ka të bëjë me:

- dhënien e interpretimeve të detyrueshme të Kushtetutës;
- dhënien e vendimeve lidhur me kushtetutshmërinë e ligjeve dhe të akteve të Presidentit;
- zgjedhjen e konfliktit për kompetencë në mes të organeve qendrore dhe në mes tyre dhe organeve të vetëqeverisjes lokale;
- vendosjen për kushtetutshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare para se të ratifikohen si dhe vendosjen lidhur me pajtueshmërinë e ligjeve me marrëveshjet ndërkombëtare dhe standardet e përgjithshme ndërkombëtare të cilat janë të detyrueshme për Bullgarinë;
- vendosjen lidhur me çdo çështje kushtetuese që ka të bëjë me parti politike dhe shoqata të qytetarëve;
- vendosjen lidhur me çdo çështje kushtetuese që mund të dalë nga zgjedhja e Presidentit dhe zëvendëspresidentit;
- vendosjen lidhur me çdo çështje kushtetuese që mund të lindë nga zgjedhja e përfaqësuesit nacional;

Një dispozitë jashtëzakonisht e qëlluar dhe specifike e Kushtetutës gjendet në paragrafin e fundit të nenit 149 si më sipër. Në këtë dispozitë qartë përcaktohet se autorizimet dhe detyrat e **GJKBu** nuk mund të caktohen dhe as të merren me ligj. Ky qëndrim i kushtetutëbërësit bullgar e fuqizon dukshëm konceptin

---

80 *Law No. 124-L of 6 January 2014 of the Republic of Belarus on the Constitutional Proceedings* (published on National Legal Internet Portal of the Republic of Belarus, 16. 01. 2014 , 2/2122). Adopted by the House of Representatives on December 16, 2013. Aproved by the Copuncil of the Republic on December 19, 2013). Burimi në internet: http://www.kc.gov.by/en/main.aspx?guid=13225# (shikuar në prill 2017).

81 *The Constitution of Bulgaria of 1991 with Amendments through 2007*. Burim në internet: https://www.constituteproject.org/constitution/Bulgaria_2007.pdf?lang=en (shikuar në prill 2017).

evropian/kelsenian klasik të gjyqësisë kushtetuese, e cila ushtrohet nga një organ i ndarë dhe me kompetenca qartë të përcaktuara kushtetuese. Caktimi i juridiksionit, sipas botëkuptimit klasik kelsenian, duhet të ndodhë sipas sistemit të enumeracionit pozitiv, pra duke numëruar taksativisht se çka ka të drejtë dhe autorizim për të vendosur gjykata kushtetuese e një vendi. Më këtë përcaktim, bullgarët kanë penguar që dikush të mund t'i japë **GJKBu** autorizime dhe juridiksion shtesë me ligj, apo t'ia marrë përmes ligjeve ato që i ka të përcaktuara me Kushtetutë. Kjo është themeli i sigurisë juridike, i sundimit të ligjit dhe, mbi të gjitha, i forcimit të gjyqësisë kushtetuese si një garant dhe sigurues i ruajtjes së supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës kundrejt çdo akti tjetër juridik në vend.

Organizmi dhe procedura e **GJKBu**, si në vendet tjera në shumicën dërrmuese të rasteve, përcaktohet me ligj të veçantë[82].

Edhe **Republika e Gjeorgjisë,** si një ndër ish-republikat sovjetike, ka zgjedhur rrugën **evropiane/kelseniane** të gjyqësisë kushtetuese. **Gjykata Kushtetuese e Gjeorgjisë** (GJKGjo) është e ndarë nga gjyqësori i rregullt dhe ka juridiksion të qartë të përcaktuar me Kushtetutë. **Kushtetuta e Gjeorgjisë** e vitit 1995, aktualisht në fuqi[83], rregullon juridiksionin, palët e autorizuara dhe çështjet tjera kushtetuese lidhur me funksionimin dhe punën e Gjykatës në nenet 88-89 të kapitullit të pestë ["Autoriteti Gjyqësor"] kurse me dy ligje tjera rregullohet organizimi, procedura dhe çështjet tjera të brendshme.

GJKGjo ka tri specifika që e dallojnë nga zgjidhjet kushtetuese të vendeve tjera që u diskutuan më sipër dhe që i takojnë sistemit **evropian/kelsenian**. Kjo gjykatë, në veçanti dallohet nga zgjidhjet kushtetuese të përqafuara në ish-republikat sovjetike me të cilat Gjeorgjia ka jetuar për dekada nën sundimin sovjetik. Këto tri specifika kanë të bëjnë me vendin dhe statusin kushtetues të Gjykatës, me mundësinë që kjo gjykatë përmes ligjit organik të fitojë kompetenca shtesë nga ato të përcaktuara me nenin 89 të Kushtetutës dhe, së fundi, me përbërjen e Gjykatës nga Plenumi dhe dy borde, secili me kompetenca të veta të qarta dhe të ndara nga tjetri.

Sa i përket vendit dhe statusit të Gjykatës Kushtetuese, paragrafi i parë i nenit 82 të kapitullit të pestë ["Autoriteti Gjyqësor"] të Kushtetutës përcakton si pjesë të autoritetit gjyqësor. Ky autoritet, thuhet në këtë nen, "ushtrohet përmes kontrollit kushtetues, drejtësisë, dhe formave tjera të përcaktuara me ligj". Në paragrafin e parë të nenit në vijim, nenit 83, Gjykata definohet në mënyrë shprehimore si "një trup gjyqësor që kryen kontrollin kushtetues". I njëjti nen në fjalinë e fundit përcakton se krahas Kushtetutës, një ligj organik i cakton autorizimet, krijimin dhe aktivitetet e **GJKGjo**. Në fakt, çështjet e aktivitetit të Gjykatës janë të rregulluara me **Ligjin Organik të Gjeorgjisë mbi Gjykatën Kushtetuese** të datës 31 janar 1996, me amendamentet e mëvonshme[84], dhe me **Ligjin e Gjeorgjisë mbi Procedurat Kushtetuese** të datës 21 mars 1996, me amendamentet e mëvonshme[85]. Të dy këto ligje janë në fuqi aktualisht. Në ndërkohë që ligji i fundit flet për çështje tërësisht procedurale, i pari ligj e përcakton rolin dhe pozitën e **GJKGjo** qysh në nenin e parë ku flet për parimet e përgjithshme. Në këtë nen, ajo cilësohet sërish si një trup gjyqësor i kontrollit kushtetues, njëjtë si në Kushtetutë, i cili ka për qëllim primar sigurimin e supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës, të legalitetit kushtetues, si dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave kushtetuese.

Sa i përket përbërjes, kjo specifikë si duket ka rrjedhur nga emitimi i strukturës të dy senateve të **Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë** (GJKGje). Përbërja e Gjykatës, struktura dhe kompetencat e secilit prej dy trupave të Gjykatës përcaktohen me ligjin e sipërcekur organik.

---

82 *Constitutional Court Act of Bulgaria of* 30 July 1991. Burim në internet: http://www. refworld.org / docid / 44 ae2fb34.html (shikuar në prill 2017).

83 *The Constitution of Georgia of 1995 with Amendments through 2013*. Burim në internet: https://www.Constitu teproject.org/ constitution/Georgia_2013.pdf?lang=en (shikuar në prill 2017).

84 "Organic Law No. 1059 of Georgia on the Constitutional Court of 11 November 1997." *The Parliament Gazette No 45* of 21 November 1997. Burim në internet: http://www.parliament.am/library/ sahmanadrakan %20data ran/ georgia.pdf (shikuar në prill 2017).

85 *Law of Georgia On Constitutional Procedures dated March 21, 1996*. Burim në internet: . http://gov.ge/index . php?lang_ id=ENG&sec_id=160 (shikuar në prill 2017).

Sipas nenit 11.1 ["Kapitulli II: Përbërja dhe Struktura e Gjykatës Kushtetuese"] të **Ligjit Organik mbi Gjykatën Kushtetuese të Gjeorgjisë**, Gjykata përbëhet nga Plenumi dhe dy borde. Kushtetuta fare nuk flet për këtë strukturë. Ligji në fjalë, në fakt, flet jo vetëm për ndarjen e kompetencave në mes të Plenumit dhe secilit prej dy bordeve por edhe për kompetencën e tërësishme të Gjykatës Kushtetuese. Këtë e bën në nenin 19 [„Autorizimet e Gjykatës Kushtetuese"]. Bashkërisht, neni 89 i Kushtetutës dhe neni 19 i Ligjit organik përcaktojnë juridiksionin dhe palët e autorizuara të **GJKGjo.** Ani se shumica e juridiksionit gjendet në nenin 89 të Kushtetutës, neni 19 i Ligjit organik e plotëson dukshëm këtë juridiksion në lidhje me caktimin e përgjegjësisë kushtetuese të Presidentit dhe organeve tjera qendrore, lidhur me kushtetutshmërinë e organizimeve të qytetarëve, kushtetutshmërinë e autonomive regjionale dhe kështu me radhë.

Në nenin në vijim, në nenin 21 të Ligjit organik përcaktohen në detaje kompetencat e Plenumit dhe të secilit prej dy bordeve si dhe koordinimi në mes tyre me qëllim të evitimit të vendimeve kontradiktore. Sipas këtij neni, Plenumi ka këto autorizime:

- vendos lidhur me pajtueshmërinë me Kushtetutën e Gjeorgjisë të marrëveshjeve kushtetuese, ligjeve të Gjeorgjisë, akteve normative të Parlamentit, akteve normative të Presidentit të Gjeorgjisë, si dhe të trupave të lartë shtetërorë të **Abhazisë** dhe **Republikës Autonome Ajaria**, si dhe lidhur me pajtueshmërinë e miratimit, nënshkrimit, shpalljes dhe hyrjes në fuqi të akteve legjislative të Gjeorgjisë dhe vendimeve të Parlamentit me Kushtetutën e Gjeorgjisë;
- vendos lidhur me kontestet që kanë të bëjnë me kushtetutshmërinë e referendumit, zgjedhjeve për Parlament dhe zgjedhjen e Presidentit;
- shqyrton kushtetutshmërinë e marrëveshjeve dhe traktateve ndërkombëtare;
- nxjerr konkluzione lidhur me cenimin e Kushtetutës së Gjeorgjisë nga ana e Presidentit të Gjeorgjisë, Presidentit të Gjykatës Supreme të Gjeorgjisë, një anëtari të Qeverisë së Gjeorgjisë, Prokurorit të Përgjithshëm të Gjeorgjisë, Presidentit të Dhomës së Kontrollit të Gjeorgjisë, si dhe nga ana e anëtarëve të Bankës Nacionale të Gjeorgjisë;
- shqyrton parashtresat e gjykatave të kompetencës së përgjithshme. Këto parashtresa mund të paraqiten atëherë kur gjatë vendosjes së një rasti apo mosmarrëveshjeje konkrete, gjykata e rregullt me juridiksion e përgjithshëm vjen në përfundim se ka bazë të mjaftueshme për të konsideruar se ligji apo akt tjetër normativ të cilin gjykata në fjalë duhet ta zbatojë në rastin konkret nuk është në pajtim me Kushtetutën, pjesërisht apo në tërësi.

Kurse secili nga dy bordet, sipas po të njëjtit nen të Ligjit organik, nenit 21, ka këto autorizime për shqyrtim dhe vendosje lidhur me:

- një konflikt për kompetencë në mes të trupave shtetërorë;
- kushtetutshmërinë e formimit dhe aktivitetit të shoqatave politike të qytetarëve;
- kushtetutshmërinë e zgjedhjeve për vetëqeverisjen lokale;
- kushtetutshmërinë e akteve normative të miratuara në vijim të zbatimit të kapitullit dy të Kushtetutës së Gjeorgjisë (shtetësia gjeorgjiane, të drejtat dhe liritë themelore të individit);
- njohjen e ndërprerjes së parakohshme të mandatit të anëtarit të Parlamentit të Gjeorgjisë.

Në rastet kur çështja kushtetuese prek lëmin që në të njëjtën kohë bie nën juridiksionin e Plenumit dhe të njërit nga bordet, atëherë është Plenumi ai që vendos çështjen e tillë kushtetuese.

Në **Republikën e Moldavisë,** si një ish-republikë sovjetike, gjyqësia kushtetuese e modelit **evropian/kelsenian** nis më 1995, kur u themelua **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Moldavisë (GJKMo).** Kjo u bë e mundur pas nxjerrjes së **Kushtetutës së Moldavisë** të vitit 1994[86]. Përveç neneve 113-121 të kapitullit IX [„Gjyqësori"] të Kushtetutës, të cilat sanksionojnë juridiksionin dhe vendin e gjykatave të rregullta në kuadër të sistemit gjyqësor moldavian, ekziston edhe një pjesë e veçantë dhe e ndarë e Kushtetutës, pjesa

[86] *Constitution of the Republic of Moldova of 1994 with Amendments through 2006*. Burim ne internet: https://www.constituteproject.org/constitution/Moldova_2006.pdf?lang=en (shikuar në prill 2017).

e pestë me nenet e veta 134-140, e cila flet vetëm për **GJKMo**. Gjyqësori i rregullt rregullohet në kuadër të titullit III të Kushtetutës, i cili flet për autoritetet publike: Parlamentin, Presidentin, Qeverinë, Administratën Publike dhe Gjyqësorin.

Kushtetuta bën dallimin në mes të statusit të **GJKMo** dhe autorizimeve të saj. Ajo ka statusin e trupit të vetëm të veshur me juridiksion kushtetues, i cili është autonom dhe i pavarur nga ekzekutivi, ligjvënësi dhe gjyqësori moldavian[87]. Ky përcaktim e bën të qartë fizionominë **evropiane/kelseniane** të **GJKMo**, si një trup i ndërmjetëm, i cili kontrollon tri degët e pushtetit shtetëror (legjislativin, ekzekutivin dhe gjyqësorin). Është trup i ndërmjetëm me juridiksion të qartë kushtetues të përcaktuar në nenin 135 ["Autorizimet"] të Kushtetutës. Ky juridiksion assesi nuk do të thotë se në pikëpamje hierarkike **GJKMo** gjendet mbi tri pushtetet apo se është pjesë e tyre. Juridiksioni nga neni 135 i Kushtetutës ngërthen në vete disa detyrime të cilat përshkruhen në nenin paraprak, nenin 134, dhe kanë të bëjnë me sa vijon:[88]

- garantimi i supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës;
- sigurimi i parimit të ndarjes se pushteteve në pushtet legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor;
- garantimi i mbikëqyrjes së përgjegjësisë së shtetit ndaj qytetarit dhe anasjelltas;

Ky status dhe kjo fizionomi e **GJKMo**, e përshkruar në nenin 134 të Kushtetutës, operacionalizohet me tutje në nenin në vijim, në nenin 135, përmes përshkrimit të autorizimeve konkrete. Në mesin e tyre, bie në sy autorizimi për interpretim të Kushtetutës, d.m.th. autorizimi i saj për të interpretuar tekstin kushtetues jashtë një rasti apo mosmarrëveshjeje konkrete, jashtë ekzistimit të një ligji apo norme tjetër juridike apo veprimi të cilët do të subsumoheshin (nënviheshin) si fakte (rrethana) jetësore kundruall një norme kushtetuese për të testuar kushtetutshmërinë e tyre, pra për të vlerësuar (testuar) kushtetutshmërinë e një ligji, norme juridike apo veprimi duke i nënvënë (subsumuar) të njëjtat kundruall një norme kushtetuese.

Autorizimet e **GJKMo**, të përcaktuara në nenin 135 të Kushtetutës, janë si vijon:

- ushtron, sipas kërkesës, kontrollin kushtetues të ligjeve dhe vendimeve të Parlamentit, dekreteve presidenciale, vendimeve dhe urdhrave të Qeverisë, si dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare ku Republika e Moldavisë është palë;
- jep interpretime të Kushtetutës;
- formulon pozicionin e saj lidhur me iniciativat që kanë të bëjnë me amendamentimin e Kushtetutës;
- vërteton rezultatet e referendumit republikan;
- vërteton rezultatet e zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale në Republikën e Moldavisë;
- vërteton rrethanat të cilat arsyetojnë shpërndarjen e Parlamentit, pezullimin nga detyra të Presidentit të Republikës apo të ushtruesit të detyrës së Presidentit, si dhe pamundësinë e Presidentit të Republikës së Moldavisë për të ushtruar në mënyrë të plotë të detyrat e tij funksionale për më shumë se 60 ditë;
- zgjidh kërkesat lidhur me jokushtetutshmërinë e akteve juridike, ashtu siç është pohuar nga Gjykata Supreme e Drejtësisë.

Në paragrafin e dytë dhe të fundit të këtij neni përcaktohet një autorizim i veçantë i Gjykatës: ajo mund të procedojë vetëm sipas iniciativës (kërkesës) së një pale të autorizuar, pra jo **sua sponte** (me vetiniciativë). Kjo palë, sipas po këtij paragrafi, caktohet me ligj dhe jo me Kushtetutë. Një gjë e tillë është bërë me nenin 25 ["Palët e Autorizuara"] të **Ligjit mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e Gjykatës Kushtetuese të Republikës të Moldavisë** i vitit 1994[89]. Ky nen i numëron në mënyrë taksative palët e autorizuara për të iniciuar (nisur) procedurën para **GJKMo**. Ato palë këtu janë afërsisht të njëjta me

87 Neni 134 paragrafet 1 dhe 2 ["Statusi"] të Kushtetutës.

88 Neni 134.3 ["Statusi"] i Kushtetutës.

89 **Law** *No. 317-XII on* **the Organisation and Operation of the Constitutional Court of the Republic of Moldova of 13 December 1994. Burim në internet:** http://www.legislationline.org/documents/action/popup/id/16661 **(shikuar në prill 2017) .**

zgjidhjet kushtetuese të vendeve tjera ashtu që këtu nuk diskutohen në detaje. Në kuadrin e palëve të autorizuara nuk bëjnë pjesë individët, gjë që do të thotë se në **Moldavi** nuk ekziston **ankesa kushtetuese** si mjet juridik për vënien në jetë të të drejtave dhe lirive kushtetuese, por mbrojtja e tyre bëhet në kuadër të gjyqësorit të rregullt dhe organeve tjera të pushtetit shtetëror. Thënë ndryshe, si palë me legjitimitet aktiv për të vënë në lëvizje procedurën pranë saj, sipas nenit 25 si më sipër, paraqiten vetëm ato palë që nuk kanë nevojë të provojnë ekzistimin e interesit juridik-kushtetues individual (në dobi të tyre). Këto ndryshe njihen si palë të privilegjuara sepse nuk kanë nevojë të provojnë jokushtetutshmërinë e ligjit apo të akteve tjera juridike, të cilat i sfidojnë në procedurë pranë **GJKMo**.

Në mesin e shumë çështjeve, tri sosh janë specifike për gjyqësinë kushtetuese të këtij vendi, të cilat duhet të veçohen me këtë rast. E para, sikundër vërehet më lartë, **GJKMo** ka autorizim për dhënien e mendimeve këshillëdhënëse, gjë e cila shprehimisht vërtetohet me nenin 26 ["Aktet e Gjykatës Kushtetutese"] të Ligjit, i cili përveç aktgjykimeve dhe vendimeve, flet edhe për mendimet këshillëdhënëse të cilat mund t'i japë ajo. Ky juridiksion është i rrallë në kuadër të gjyqësisë kushtetuese dhe e parashohin shumë pak kushtetuta.

Si specifikë e dytë është se Ligji, në nenin 4 ["Prerogativat"], nën germën "h", ia shton **GJKMo** një kompetencë, e cila ka të bëjë autorizimin e saj për të vlerësuar kushtetutshmërinë e partive politike. Kjo do të thotë se juridiksioni i gjyqësisë kushtetuese moldaviane nuk përcaktohet në mënyrë taksative me Kushtetutë por edhe me ligjin që rregullon organizimin dhe veprimtarinë e **GJKMo**. Kjo qasje, sikundër është vërejtur tanimë, përbën një fenomen mjaft të përhapur dhe nuk paraqet cilësi të gjyqësisë kushtetuese **evropiane/kelseniane**, e cila niset nga premisa klasike sipas së cilës gjykatat kushtetuese duhet t'i kenë të numëruara në tekstin kushtetues në mënyrë taksative kompetencat që bien në kuadër të juridiksionit të tyre kushtetues.

Si specifikë e fundit është se palët e autorizuara përcaktohen me Ligj dhe jo me Kushtetutë. Kjo, në fakt, përbën një risi dhe një zgjidhje që nuk haset nëpër vendet tjera që kanë gjyqësi kushtetuese **evropiane/kelseniane**.

Ndër vendet ish-komuniste, **Rumania** ka një gjyqësi kushtetuese mjaft interesante sepse përmban elemente të sistemit francez dhe të atij evropian/kelzenian: **francez** për aq sa bëhet fjalë për juridiksionin e **Gjykatës Kushtetuese të Rumanisë (GJKRu)** për kontroll preventiv të ligjeve, juridiksion i pandryshuar që nga themelimi, kurse **evropian/kelsenian** për sa i përket zgjidhjes institucionale dhe formës së jashtme përmes së cilës manifestohet ushtrimi i gjyqësisë kushtetuese rumune. Si për sa i përket elementeve të modelit francez ashtu edhe sa i takon atyre të evropian/kelsenian, që nga themelimi **GJKRu** ka kaluar nëpër dy faza: faza e parë nis me themelimin e saj në vitin 1991 dhe zgjat deri me miratimin e amendamenteve kushtetuese të vitit 2003, kurse e faza e dytë nis me vitin 2003 dhe vazhdon deri në kohën e sotme.

Gjykata është themeluar më 1991 në bazë të **Kushtetutës së Rumanisë** të vitit 1991,[90] e cila nën nenin 146 përcakton kompetencat e saj. Zgjidhja institucionale rumune i përket sistemit **evropian/kelsenian**, pa asnjë dyshim, sepse në kushtetutë ajo figuron si një institucion i ndërmjetëm, i ndarë nga gjyqësori i rregullt, me kompetenca krejt të qarta dhe të veçanta nga ato të gjyqësorit të rregullt. Në këtë kontest, megjithatë, deri me ndryshimet kushtetuese të vitit 2003, **GJKRu** ka ruajtur disa relikte nga përvoja e para **Luftës së Dytë Botërore** sa i përket supremacisë (epërsisë) së Parlamentit: në fillim, më 1991, u fut zgjidhja që Parlamenti mund të rrëzonte me një shumicë të kualifikuar prej dy të tretave çdo vendim të saj me të cilin konstatohej një shkelje kushtetuese. Kjo i jepte mundësi kushtetuese Parlamentit që të rrëzojë, përkatësisht të konvalidojë (të shërojë) çdo ligj apo veprim tjetër të një autoriteti publik të shpallur si jo kushtetues nga **GJKRu** me një shumicë të kualifikuar prej dy të tretave të votave parlamentare. Ngjashëm me këtë sot ekziston zgjidhja kushtetuese që ka të bëjë me propozimin për

[90] The Constitution of Rumania of 1991 with Amendments through 2003. Burim interneti: https://www. constituteproject.org/constitution/Romania_2003.pdf?lang=en (shikuar në prill 2017).

suspendim të shefit të shtetit rumun nga detyra. Në këtë proces, **GJKRu** dhe Parlamenti kanë detyrat e ndara: Gjykata në këtë mes jep mendim këshillëdhënës, kurse Parlamenti vendosë për suspendimin e shefit të shtetit. Me amendamentet e vitit 2003, megjithatë, Parlamenti nuk ka supremaci (epërsi) për fatin e shefit të shtetit sepse verdikti merret nga sovrani përmes referendumit ashtu që vetë sovrani vendos për shkarkimin përfundimtar të shefit rumun të shtetit, i cili është suspenduar me vendim të Parlamentit dhe me mendimin këshillëdhënës të Gjykatës[91]. Kjo do të thotë se Parlamenti ka të drejtën e propozimit për shkarkim, duke e suspenduar dhe duke e vënë ushtruesin e detyrës së Shefit të Shtetit, i cili vendim pastaj shkon për kontroll kushtetues në **GJKRu**, e cila, nga ana e saj, e jep një mendimin këshillëdhënës dhe, në fund, tërë ky proces votohet në referendum. Kjo do të thotë se këtu **GJKRu** ka rol këshillëdhënës dhe sovrani është ai që ka epërsi kundrejt Kushtetutës, jo Parlamenti i Rumanisë sepse mendimi këshillëdhënës i saj nuk mund të votohet në Parlament: së bashku me vendimin e këtij të fundit, mendimi këshillëdhënës i Gjykatës shkon për votim në referendum të sovranit. Deri më sot ka pasur vetëm një proces të tillë, por që sovrani rumun ka votuar kundër shkarkimit të shefit rumun të shtetit, duke mos dalë në referendum në numrin që kërkohet me ligj, përkatësisht duke mos dalë gjysma plus një e të gjithë votuesve të regjistruar në listat e votuesve.[92]

Zakonisht, kushtetutat shumë rrallë parashikojnë që organi përfaqësues të arrijë të përmbysë më një shumicë të caktuar një verdikt të gjykatës kushtetuese sepse një gjë e tillë bie ndesh me vetë konceptin e demokracisë kushtetuese ku gjykatat kushtetuese (apo organet tjera ekuivalent me to) kanë për detyrë të kujdesen për sigurimin e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës kundrejt çdo vullneti apo veprimi të sovranit të shprehur përmes organit përfaqësues. Zgjidhja ku organi përfaqësues ka të drejtën e rrëzimit të verdiktit të gjykatës kushtetuese (ose të organit tjetër ekuivalent) me një shumicë të caktuar është e rrallë sepse ekziston supozimi sipas të cilit supremacia (epërsia) e kushtetutës garantohet dhe sigurohet përmes gjykatës kushtetuese (dhe organit tjetër ekuivalent me të), e jo përmes organit përfaqësues. Në fakt, siç kemi folur në kapitujt pararendës, vetë lindja e gjyqësisë kushtetuese **evropiane/kelseniane** ka ndodhur falë luftës së demokracive liberale për kontroll kushtetues të vullnetit të shumicës së përfaqësuar në organin përfaqësues. Kjo mbrojtje përmes gjyqësisë kushtetuese kundër tiranisë së shumicës ka ardhur në veçanti në shprehje në sistemet federale. Sërish arsyeja e ekzistimit të gjyqësisë kushtetuese ngelet e njëjtë, pra mbrojtja e balanseve federale ku sërish ekziston një shumicë e cila mund ta tiranizojë pakicën në nivel federal. Në fakt, ka qenë pengimi i tiranisë së shumicës dhe sigurimi i balanseve federale që kanë përbërë **raison d'etre** të lindjes dhe zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese, dje dhe sot. Kështu do të jetë edhe në ta kaluarën. Këtyre dy arsyeve mund t›i shtohet, dhe iu kanë shtuar, disa arsye tjera, siç janë mbrojtja e lirive dhe të drejtave njerëzore, zgjidhja e konflikteve për kompetencë në mes të organeve shtetërore, sigurimi i tranzicionit demokratik nga një sistem diktatorial në atë demokratik etj, etj.

---

91 Neni 146 ["Funksionet e Gjykatës Kushtetuese"] i Kushtetutës, në paragrafin e parë nën "g" dhe "i" përcakton se kur dhe si mund të suspendohet shefi i shtetit rumun nga ana e Parlamentit. Kjo procedurë mund të vihet në jetë vetëm nëse respektohen dispozitat e neneve 42-32 ["Çështja e Propozimit për Suspendim të Presidentit të Republikës"] dhe 44 ["Konstatimi i Rrethanave për Caktimin e Ushtruesit të Detyrës së Presidentit të republikës"] të Ligjit nr. 47/1992 mbi Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese i datës 18 maj 1992. Burim në internet: http://www.servat.unibe.ch/icl/ro01000_.html (shikuar në prill 2017).

92 Në këtë rast, Presidenti i Rumanisë qe suspenduar nga detyra me vendim të Parlamentit, kurse Gjykata Kushtetuese kishte thënë se procedura ka qenë në rregull, mirëpo në referendumin e mbajtur populli rumun tha se shkarkimi i Shefit të Shtetit nuk mund të ndodhë pasi nuk mori pjesë në te në numrin e caktuar të vlefshëm për një referendum. Cf. "ADVISORY OPINION no. 1 of 6 July 2012 of the Constitutional Court, concerning the proposal to suspend from office the President of Romania, Mr. Traian Băsescu"; dhe "RULING no. 6 of 21 August 2012 on the compliance with the procedure for the organization and conduct of the national referendum of 29 July 2012 for the dismissal of the President of Romania, Mr. Traian Basescu, and on the confirmation of its results." Në EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION), *CONSTITUTIONAL ISSUES IN ROMANIA. DECISIONS, RULINGS AND OPINIONS OF THE CONSTITUTIONAL COURT (Translations from Romanian provided by the Romanian Authorities).* Opinion 685/2012. CDL-REF(2012)031 (Engl. only). Strasbourg, 5 September 2012, fq. 3-21; 93-100. Në internet: http://www.venice.coe.int/webforms/do cuments/default.Aspx?pd ffile=CDL-REF(2012)031-e (shikuar në qershor 2018).

Jo të gjitha vendet e ish-lindjes komuniste i kanë rezistuar kësaj sfide, sfidës që ofron një sundim me vlerë absolute të gjyqësisë kushtetuese dhe verdikteve të saj. **Rumania** bën pjesë ne vendet e rralla në Evropë që deri më 2003 ka parashikuar ruajtjen e supremacisë (epërsisë) së parlamentit, duke ia njohur këtij organi të drejtën për të rrëzuar më një shumicë të dy të tretave çdo verdikt të **GJKRu**. Kjo ka një shpjegim dhe një histori të veçantë, të cilin e sqarojmë në rreshtat në vijim.

Asambleja Kushtetuese e Rumanisë, e krijuar pas zgjedhjeve të majit 1990, nga shtatori 1990 deri në nëntor të vitit 1991, ka luftuar fuqishëm, por pa sukses, për rikthimin e traditës rumune të para Luftës së Dytë Botërore, traditë e bazuar në sistemin amerikan të gjyqësisë kushtetuese[93]. Kjo traditë ka qenë shumë prezente që nga fillimi i shekullit XX. Në rastin e njohur të vitit 1912, të cilin e kemi zënë në gojë në kapitullin paraprak kur kemi folur për historikun e lindjes së gjyqësisë kushtetuese në Evropë, i njohur ndryshe edhe si "rasti i ligjit të kompanisë së tramvajave",[94] **Gjykata e Kasacionit e Rumanisë** ka përkrahur kërkesën që thoshte se ligji duhej shpallur si jo kushtetues edhe në rastet kur teksti kushtetues nuk parashikon në mënyrë shprehimore një gjë të tillë[95]. Në mënyrë të çuditshme, ky vendim është pasojë dhe rezultat imediat i ndjekjes së një këshille të ekspertëve francezë, në një kohë që vetë **Franca** kishte shumë mëri ndaj kontrollit gjyqësor të ligjeve, të cilat i shihte si shprehje e supremacisë (epërsisë) së parlamentit që duhej të mbizotëronte në çdo aspekt[96].

Ndikimi francez, megjithatë, u pa edhe pas rënies së komunizmit më 1989: neni 145 i Kushtetutës së vitit 1991, parashikonte shpalljen dhe hyrjen në fuqi të çdo ligji apo akti tjetër të cilin Gjykata me verdikt e kishte deklaruar si jo kushtetues. Kjo, siç u tha më sipër, kërkonte një shumicë prej dy të tretave të Parlamentit. Kjo dispozitë është fshirë me amendamentet e vitit 2003. Si e tillë, kjo dispozitë ka qenë një relikt të supremacisë (epërsisë) së parlamentit. Relikt tjetër, përveç këtij, është edhe ai që flet për kontrollin preventiv të ligjeve (para shpalljes së tyre), i cili është ruajtur edhe sot si pasojë e ndikimit francez, kurse kontrolli **in concreto** (incidental) i normës mëton të ruajë fytyrën e parlamentit rumun duke lejuar që të vlerësohet kushtetutshmëria e normës pasi të jetë testuar në praktikë. Kjo përvojë, megjithatë, nuk është e ndikimit francez sepse vetë **Franca** e ka futur këtë kompetencë të re të kontrollit kushtetues në pranverë të vitit 2010, duke ia njohur **Këshillit Kushtetues** (KKFr) të drejtën e ashtuquajtur **kontrolli prioritar i kushtetutshmërisë** (**controle prioritaire de constitutionalite**). Për këtë kemi diskutuar më herët në seksionin 2.2 të kapitullit të dytë të këtij libri, por edhe në vendet tjera.

Përveç kompetencave si më sipër, **GJKRu** në nenin 146 ["Funksionet e Gjykatës Kushtetuese"] të Kushtetutës ka edhe kompetenca tjera, siç janë ato klasike të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe të dekreteve, por edhe më pak klasike, siç janë ato lidhur me kontrollin e kushtetutshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare, të kushtetutshmërisë së rregullave të procedurës së Parlamentit, të zgjidhjes së konfliktit për kompetencë në mes të organeve të ndryshme, të kontrollit incidental të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe normave tjera, të kontrollit të kushtetutshmërisë së zgjedhjes së Presidentit, të kontrollit kushtetues të partive politike etj. Në ndërkohë që më 1991 nuk u pranua që të futej klauzola sipas të cilës **GJKRu** mund të kishte edhe kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj, një gjë e tillë u lejua me paragrafin e fundit të nenit 147 të Kushtetutës. Në këtë dispozitë, në mënyrë shprehimore ajo autorizohet për të kryer edhe punë tjera të përcaktuara nga ligji i saj organik. Ky ligj është nxjerrë në maj të vitit 1992 dhe ende është në fuqi.[97]

---

93 Tudorel Toader & Marieta Safta, "Development of Constitutionalism in Romania". Në *Revista de Drept Constitutional* Issue 1 (2015) fq. 205-254 në fq. 207-210 ; Renate Weber, "The Romanian Constitutional Court : In Search of Its Oën Identity". Në Wojciech Sadurski, *Constitutional Justice, East and West. Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in A Comparative Perspective* (Kluwer Law International: The Hague, 2010) fq. 283-308 në fq. 284-286.

94 Cf. poashtu Constantin Doldur, "La Cour constitutionelle de la Roumanie". Në Giuseppe de Vergottini, *GIUSTIZIA COSTITUZIONALE E SVILUPO DEMOCRATICO NEI PAESI DELL' EUROPA CENTRO – ORIENTALE* (G. Giappichelli Editore – Torino, 2000) fq. 313-345 në fq. 315.

95 Leon Duguit, *Les transformations du droit public* (Librarie Armand Colin: Paris, 1913) fq. 101.

96 Herman Schwartz, *The Struggle for Constitutional Justice in Post-Communist Europe* (University of Chicago Press: Chicago, 2000) fq. 16-17.

97 Shih fusnotën nr. 91 si më sipër.

Në kuadër të 15 republikave ish-sovjetike ka qenë edhe **Rusia**. Deri me rënien e komunizmit, pak mund të thuhet për kontrollin kushtetues liberal perëndimor në këtë vend. Dy rastet e ekzistimit të një lloj kontrolli kushtetues në këtë vend janë larg asaj që cilësohet kontroll i kushtetutshmërisë në botën moderne. I **pari** rast lidhet me Gjykatën Supreme kurse i **dyti** shembull i kontrollit kushtetues në këtë vend ka të bëjë me kontrollin që është kryer nga ana e organeve të brendshme drejtuese të legjislativit sovjetik. Në këtë kohë, në territorin e ish-BRSS vetëm rastin i **Letonisë** në vitin 1934, është shënuar si një përpjekje e ndërmarrë në parlamentin e këtij vendi për të krijuar një gjykatë të shtetit me juridiksion të veçantë për të kryer kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve, kontrollin e ligjshmërisë së akteve normative të Këshillit të Ministrave si dhe të akteve të Presidentit.[98] Ky nuk ka qenë rasti me **Rusinë Cariste:** në kohën e regjimit carist rus, **Katerina e Dytë e Rusisë** qysh më 1767, kishte dhënë instruksione për domosdonë e kontrollit kushtetues të ligjeve që, sipas saj, duhej të ushtrohej nga ana e Senatit, organ që në atë kohë përfshinte Këshillin e Ministrave dhe Gjykatën Supreme.[99]

Rasti i parë i vënies në jetë në ish-**BRSS** të një lloj kontrolli kushtetues, pra që nuk ka ngelur në draft apo si ide e parealizuar, i cili përmendet në literaturë, ka të bëjë me Gjykatën Supreme. Në vitet ‹20 të shekullit të kaluar qe themeluar **Gjykata Supreme**, e para e këtij lloji, me dy role në vendimmarrjet kushtetuese të kohës së vet: e para, ajo ka mundur t'i rekomandojë Presidiumit të organit ekzekutiv të Sovjetit Suprem, i njohur si **Komiteti Ekzekutiv Qendror i Sovjetit Suprem**, që t'i anulojë dekretet dhe urdhrat e qeverisë qendrore, të ministrive apo agjensioneve qeveritare; e dyta, me kërkesën e vetë Presidiumit të Sovjetit Suprem, Gjykata Supreme ka mundur të japë këshilla lidhur me kushtetutshmërinë e ligjeve të republikave anëtare të ish-BRSS.[100] Më vonë, sipas Kushtetutës së vitit 1977 të ish-**BRSS**, detyra e mbikëqyrjes së zbatimit të Kushtetutës së ish-BRSS ka vazhduar të jetë në tërësi politike dhe e koncentruar në duart e **Presidiumit të Sovjetit Suprem** të ish-BRSS[101]. Në asnjë rast nuk është menduar krijimi i një organi jashtë legjislativit sovjetik me autorizime për të ushtruar kontrollin kushtetues të aktivitetit legjislativ të shtetit sovjetik që ushtrohej nga ana e Sovjetit Suprem. Ky vlerësim politik i kushtetutshmërisë së aktivitetit legjislativ në nivel qendror ka pasur për qëllim ushtrimin e kontrollit ndaj ish-republikave sovjetike, anëtarëve të Federatës, gjithnjë në frymën e idealeve komuniste të proklamuara dhe të sanksionuara me Kushtetutë.

Pas futjes së sistemit presidencial në ish-BRSS në mars të vitit 1990 dhe zgjedhjes së **Mihail Gorbaçov**it për president të ish-BRSS (**Mikhail Gorbachev** ka qenë president në vitet 1990-1991), u hapën rrugë të reja për ndryshime demokratike, përfshirë këtu edhe ndryshimet sa i përket sundimit të ligjit përmes krijimit të strukturave dhe mekanizmave të rinj për mbikëqyrjen e kushtetutshmërisë në këtë vend. Kjo ndodhi si pjesë e programit reformist të njohur **Ristrukturimi** (rusisht: **Perestrojka**) kur në maj të vitit 1990 u themelua **Komiteti i Mbikëqyrjes së Kushtetutshmërisë i BRSS-së**. Infrastruktura kushtetuese dhe ligjore për këtë organ të ri si dhe për futjen në jetë të sistemit presidencial në ish-BRSS qe krijuar më herët: amendamentet kushtetuese në Kushtetutën e ish-BRSS të vitit 1977 u bënë më 1 dhjetor 1988. Me këto amendamente u parashikua themelimi

---

98 Carna Pistan, "La giustizia costituzionale nei Paesi dell' Europa centro-orientale (Albania, Macedonia, Serbia, Montenegro, Republica Ceka, SLovacchia, Bulgaria, Romania, Bielorussia, Ucraina). Në Luca Mezzetti (ed.) , *SISTEMI E MODELLI DI GIUSTIZIA COSTITUZIONALE* (CEDAM: Padova, 2011) fq. 181-292 në fq. 184-185.

99 Ibid. fq. 184.

100 Peter H. Solomon, "The U. S. S. R. Supreme Court: History, Role, and Future Prospects". *American Journal of Comparative Law* Vol. 38 No. 1 (Ëinter 1990) fq. 127-142 në fq. 127-132; Peter B. Maggs, "The Russian Courts and the Russian Constitution". *Indiana International & Comparative Law Review* Vol.. 8 No. 1 (1997) fq. 99-117 në fq. 100.

101 Neni 121.4 i Kapitullit 15 ["Sovieti Suprem i BRSS"] i Kushtetutës thotë, *inter alia*, se "[...] Presidiumi i Këshillit Suprem të BRSS siguron respektimin e Kushtetutës së BRSS dhe pajtueshmërinë e kushtetutave dhe ligjeve të republikave anëtare me Kushtetutën dhe ligjet e BRSS [...]"; Për komente , shih Rett R. Ludëikoëski, "Soviet Constitutional Changes of the Glasnost Era: A Historical Perspective." *The New York Law School Journal of International and Comparative Law* Vol. 10 No. 2 (1989) fq. 119-150 në fq. 148.

i **Komitetit për Mbikëqyrje Kushtetuese.**[102] U desh një vit, megjithatë, për të miratuar infrastrukturën tjetër ligjore për ta vënë në jetë këtë institucion të ri dhe **sui generis** të kontrollit kushtetues. Kjo u bë më 23 dhjetor 1989, kur u miratua **Ligji i Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike mbi Kontrollin Kushtetues në BRSS.**[103] Po këtë ditë u amendamentua edhe Kushtetuta e ish-BRSS-së e vitit 1977, për të normuar pozitën e re, atë të Presidentit të BRSS-së, një institucion ky i ri i shtetit sovjetik që po shpërbëhej.

Ani se pati një jetë të shkurtër (nga maji 1990 deri në dhjetor të vitit në vijim), **Komiteti** shërbeu si një organ kuazi–gjyqësor i kontrollit të kushtetutshmërisë në ish-BRSS. Në literaturë, me plot të drejtë konsiderohet si një pararendës i **Gjykatës Kushtetuese të Federatës së Rusisë**.[104] Në kuadër të juridiksionit të tij binin çështjet e kontrollit abstrakt, mbrojtja të drejtave dhe lirive individuale të garantuara me Kushtetutën e ish-BRSS-së dhe me aktet ndërkombëtare, si dhe zgjidhja e konfliktit për kompetencë në mes të organeve shtetërore.[105] T'i shohim një nga një si duket ky juridiksion i këtij organi të çuditshëm dhe jetëshkurtër të kontrollit të kushtetutshmërisë në ish-BRSS.

Sipas nenit 124 të **Kushtetutës së ish-BRSS-së të vitit 1977** (e amendamentuar më 1 dhjetor 1988) dhe nenit 12 të Ligjit, **Komiteti** mund të vihej në lëvizje sipas kërkesës së disa prej organeve shtetërore në nivel qendror (federativ) apo me vetiniciativë për të bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe të ligjshmërisë së disa akteve normative, siç janë dekretet e Presidentit dhe urdhëresat e Këshillit të Ministrave të ish-BRSS-së. Komiteti, gjetjet e tij, të cilat quheshin konkluzione, mund t'ia paraqiste Kongresit të Deputetëve të Popullit, Sovjetit Suprem apo organeve tjera të cilat i kishin nxjerrë aktet respektive jo kushtetuese dhe joligjore. Këto konkluzione shpalleshin në gazetën zyrtare të ish-BRSS-së dhe kishin efekt këshillëdhënës, pezullues, apo efekt të anulimit.

Efekti këshillëdhënës dhe pezullues nënkuptonte se organet që kishin nxjerrë ligjin apo aktin tjetër duhej që në një afat prej tre muajve ta pajtonin aktin e tillë me Kushtetutën dhe ligjin federal, gjë që nënkuptonte se duhej të pezullohej zbatimi i ligjeve dhe akteve tjera, të cilat ishin cilësuar si jo kushtetuese dhe joligjore nga ana e **Komitetit**. Me Ligj parashihej mundësia që me një votë prej dy të tretave **Kongresi i Deputetëve të Popullit** të mund ta rrëzonte konkluzionin e Komitetit për sa i përket jo kushtetutshmërisë së një akti të Kongresit apo të kushtetutës së njërës prej republikave federale.

Komiteti fillimisht ishte menduar të ketë të drejtën e mbikëqyrjes së kushtetutshmërisë së legjislacionit republikan (krahas atij federal). Mirëpo, kjo e drejtë u mohua nga ana e vendeve baltike, por edhe nga disa prej ish-republikave tjera sovjetike, të cilat kërkonin supremacinë (epërsinë) e sovranitetit, pavarësisë dhe legjislacionit republikan ndaj atij federal. Nga kjo ka pasur përjashtim vetëm në një rast: efekti anulues i konkluzioneve të Komitetit zbatohej në rastet e ligjeve republikane vetëm atëherë kur ato cenonin të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutën e ish-BRSS dhe aktet ndërkombëtare. Pra, thënë shkurt, vetëm në rastet e shkeljeve të të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë dhe akte ndërkombëtare konkluzionet e Komitetit kishin efekt anulues. Në rastet tjera të cenimeve (shkeljeve) kushtetuese të Kushtetutës së ish-BRSS-së, të cilat nuk kishin të bënin me të drejta dhe liri njerëzore, pra në rastet e shkeljeve kushtetuese të kryera me ligj federal, dekret

---

[102] Në kohën para dhjetorit 1988 ka pasur debate në ish-BRSS, në mesin e studiuesve dhe politikës në përgjithësi, lidhur me modelin e kontrollit të kushtetutshmërisë në këtë vend. Ka pasur rezistencë të madhe ndaj çdo kontrolli kushtetues, duke ruajtur me xhelozi të madhe supremacinë e parlamentit sovjetik, Sovjetit Suprem. Në mesin e modeleve që parashikuar edhe themelimi i një gjykate të veçantë kushtetuese, si dhe lënia e kontrollit kushtetues në kompetencë të Gjykatës Supreme. Asnjëra nga këto nuk pati sukses në këtë fazë. Cf. më shumë në këtë aspekt punimin e shkëlqyer të Herbert Hausmaninger, "The Committee of Constitutional Supervision of the USSR". *Cornell International Law Journal* Volume 23 Issue 2 *Symposium* 1990 (Article 5) fq. 287-322. në fq. 288-289.

[103] Ibid. fq. 288-299.

[104] Jon M. Rodeback, "The Russian Constitutional Court: A Third Branch of the Russian Federal Government. *Sigma: Journal of Political and International Studies* Volume 12 Issue 1 (1994) fq. 1-11 në fq. 2.

[105] Ibid. fq. 302-307.

presidencial apo urdhër qeveritar federal, Komiteti vetëm mund të lëshonte konkluzion që konstaton jo kushtetutshmërinë apo jo ligjshmërinë dhe të bënte pezullimin e aktit legjislativ apo ekzekutiv dhe të apelojë te organi kompetent shtetëror që ka nxjerrë apo sponsorizuar nxjerrjen e tyre që brenda një afati prej tre muajsh t'i sjellë ato në pajtim me Kushtetutën e ish-BRSS-së.

Neni 11 i Ligjit autorizonte Komitetin për të zgjidhur konfliktet për kompetencë që lindnin nga struktura federale e ish-BRSS-së. Ato konflikte mund të ishin:

- ndërmjet ish-BRSS-së dhe republikave federale;
- ndërmjet vetë republikave federale; dhe
- ndërmjet republikave federale dhe republikave autonome, krahinave e regjioneve autonome dhe entiteteve tjera territoriale që kanë ekzistuar në kuadër të republikave federale.

Komiteti, siç u tha më sipër, nuk pati jetë të gjatë. Kjo sepse as vetë federata sovjetike nuk e pati një jetë të tillë: shpërbërja e saj hapi rrugë të reja për secilën nga ish 15 republikat sovjetike për zgjidhje kushtetuese specifike. Në thelb, themelimi i Komitetit u pa nga shumica e ish-republikave sovjetike si një organ në duart ruse për kontrollin e tyre politik dhe si një pengesë serioze për pavarësimin e tyre nga ish-BRSS-së[106]. Në një mënyrë paradoksale, megjithatë, kur në disa prej republikave anëtare të ish-BRSS-së kishte nisur themelimi i komiteteve të tyre në nivel republikan, ashtu siç parashihej me **Ligjin e Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike mbi Kontrollin Kushtetues në BRSS**, Federata e Rusisë mori një hap të kundërt, atë të themelimit të **Gjykatës Kushtetuese të Rusisë.**[107] Ky hap u themelua si reagim ndaj dobësisë së vendimeve jodetyruese të Komitetit. Megjithatë, Komiteti hapi rrugën për themelimin e një kontrolli kushtetues rus në të ardhmen, të modeluar sipas standardeve perëndimore mbi konstitucionalizmin modern, diçka që më herët kishte qenë e panjohur në këtë vend.[108]

E themeluar me **Ligjin mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës Socialiste Sovjetike Federative të Rusisë** (RSSFR), miratuar me disa ndryshime të vogla nga Kongresi i Deputetëve Popullorë të Rusisë më datën 12 korrik 1991[109], Gjykata Kushtetuese e Rusisë në fillim u quajt **Gjykata Kushtetuese e Federatës Sovjetike Socialiste të Rusisë** (GJKFSSR). Si e tillë, në fillim ka pasur një nisje të mirë: në janar të vitit 1992, nxori një vendim me të cilin anuloi dekretin presidencial me të cilin shkriheshin ministria e brendshme dhe ajo e sigurisë në një ministri të vetme. Këtë anulim Gjykata e kishte bërë në emër të sundimit të ligjit dhe ndarjes së pushteteve, duke theksuar se, sipas **Kushtetutës së Federatës së Rusisë** dhe asaj të ish-BRSS-së në fuqi në atë kohë (Kushtetuta e vitit 1977), vetëm Sovjeti Suprem mund të themelonte ministri dhe të bënte shkrirjen e tyre. Ky vendim, në fillim u duk si një arritje e madhe sepse jo vetëm që u respektua nga presidenti rus i kohës, **Boris Jelcin** (**Boris Yeltsin,** ka qenë president nga 1991 deri më 1999),[110] por edhe për faktin se modeli i gjyqësisë kushtetuese ruse ishte **evropian/kelzenian**: vendimet ishin me efekt **erga omnes** të pavlefshmërisë, nuk mund të apeloheshin nga askush dhe

---

106 Herbert Hausmaninger, "The Committee of Constitutional Supervision of the USSR". *Cornell International Law Journal* Volume 23 Issue 2 *Symposium* 1990 (Article 5) fq. 287-322. në fq. 292-295 ; dhe Herbert Hausmaninger, "From the Soviet Committee of Constitutional Supervision to the Russian Constitutional Court" *Cornell International Law Journal* Volume 25, Issue 2 (Spring 1992) fq. 305- 337 në fq. 326-327.

107 Sipas këtij ligji duhej të formoheshin komisionet e njëjta si ai në nivel të ish-**BRSS** për mbikëqyrjen të kushtetutshmërisë në nivel jo vetëm të ish njësive federale por edhe të autonomive sovjetike . Cf. Ibid. fq. 332.

108 Herbert Hausmaninger, "From the Soviet Committee of Constitutional Supervision to the Russian Constitutional Court", fq. 330.

109 Jane Henderson, "The Constitutional Court of the Russian Federation: the Establishment and Evolution of Constitutional Supervision in Russia". Në Andreë Harding and Peter Leyland (eds.), *Constitutional Courts. A Comparative Study* (Wildy, Simmonds & Hill Publishing: London, 2009) fq. 150-152. (për Ligjin, shih fusnotën nr. 13 dhe tekstin që e shoqëron, ku diskutohet historiku i miratimit të tij).

110 Herbert Hausmaninger "From the Soviet Committee of Constitutional Supervision to the Russian Constitutional Court". *Cornell International Law Journal* Volume 25 Issue 2 (Spring 1992) fq. 333-336 (diskutimi i detajuar i rastit dhe dorëzimin e Presidentit **Boris Jelcin** para autoritetit të Gjykatës dhe rikthimin e vendimit në pikën zero, përkatësisht restaurimin e dy ministrive në pozitat e tyre juridiko-kushtetuese që i kishin pasur para shkrirjes së tyre në një ministri të vetme).

kishin efekte juridike si **ex nunc** ashtu edhe **ex tunc**, në vartësi prej natyrës së shkeljes kushtetuese dhe pasojat e prodhuara nga shkelja e tillë.[111] Në të njëjtën mënyrë, palët e autorizuara ishin të njëjta me modelin evropian/kelzenian, organet qendrore të pushtetit apo individët, krejt kjo me qëllim të promovimit të sundimit të ligjit dhe të demokracisë kushtetuese në një vend që kishte dalë nga sundimi gati njëshekullor komunist.[112]

Në zhvillimin e **GJKFSSR-së**, më vonë e riemërtuar më 1993 në **Gjykatën Kushtetuese të Federatës së Rusisë** (GJKFR), emër që edhe sot e mban, në literaturë, zakonisht me plot të drejtë, veçohen dy faza: faza e parë nga themelimi deri më 1995, kurse faza e dytë pas këtij viti e deri më sot.[113] Në fazën e parë, Gjykata pati shumë sukses dhe u bë një aktor i rëndësishëm i jetës kushtetuese dhe politike ruse, një instrument i rëndësishëm i sundimit të ligjit dhe demokracisë kushtetuese në një vend që për një shekull nuk kishte pasur një traditë legale të tipit perëndimor. Mbi të gjitha, Gjykata u pa si një instrument i dobishëm në sigurimin e ndarjes së pushteteve dhe balansimin e tyre, përkundër faktit se Rusia nuk kishte një traditë të ndarjes së pushteteve dhe balansimit të tyre. Literatura mbi gjyqësinë kushtetuese, këtë gjykatë e futi në kuadër të modeleve **evropiane/kelzeniane** të ndikuara nga gjyqësia kushtetuese gjermane, austriake dhe italiane.[114] Jo vetëm kaq: duke marrë parasysh mungesën thuajse të tërësishme të përvojës në konstitucionalizmin liberal perëndimor (sundimi i ligjit dhe ndarja e balansimi i pushteteve, respektimi i lirive dhe të drejtave njerëzore dhe të minoriteteve), kuadrit të juristëve rusë të shkolluar kryesisht në sistemin komunist, **GJKFR-ja** në vitet e para, së bashku me dy gjykatat tjera të larta të sistemit gjyqësor rus (Gjykata Supreme dhe Gjykata e Lartë e Arbitrazhit), ka shërbyer si një katalizator i fuqishëm i zhvillimit të konstitucionalizmit modern në këtë vend.[115]

Ndër kompetencat e rëndësishme që promovoi aktivizim gjyqësor pozitiv dhe të dobishëm për Rusinë e kësaj periudhe ka qenë kompetenca e Gjykatës për të vlerësuar kontrollin e kushtetutshmërisë së praktikës gjyqësore lidhur me zbatimin e ligjit. Përmes këtij juridiksioni Gjykata kishte arritur në vitet e para që të nxjerrë jashtë loje disa interpretime dhe praktika të ligjeve që i takonin kohës komuniste dhe që duheshin ndryshuar në mënyrë urgjente sepse cenonin të drejtat dhe liritë kushtetuese të qytetarëve rusë[116]. Ky aktivizëm gjyqësor nuk paraqiste ndonjë pengesë dhe shikohej me admirim nga publiku, qarqet akademike dhe pushteti në **Rusi,** për arsye se vihej në mbrojtje të të drejtave e lirive të individit kundër arbitraritetit të pushtetit shtetëror. Gjendja ndryshoi vetëm atëherë kur Gjykata nisi të bëhej, me vetiniciativë, jo vetëm arbitër por edhe palë në konfliktet për pushtet në mes të Presidentit **Boris Jelcin** dhe **Sovjetit Suprem të Rusisë** (Parlamentit) në vitin 1993[117]. Në konfliktin për pushtet në mes të ekzekutivit rus të **Boris Jelcin**it dhe Parlamentit, Gjykata mbajti anën e Parlamentit konservativ të dominuar nga ish-komunistët rusë.[118] Kjo rrethanë çoi deri te suspendimi i punë së Gjykatës me dekret presidencial

---

111 Ibid. fq. 322.

112 Cf. Ibid. fq. 333-336, si dhe konkluzionet e punimit në fjalë në fq. 337.

113 Peter B. Maggs, op. cit. fq. 103.

114 Cf. Jane Henderson, Op. Cit. në fq 151 dhe literaturën e cekur aty.

115 Cf. Peter B. Maggs, Op. Cit. (ku autori diskuton faktorët e ndryshëm që kanë ndikuar në fuqizimin e rolit të gjyqësorit rus për të shërbyer si një katalizator i ngritjes së vetëdijes ruse mbi konstitucionalizmin modern dhe zbatimin e drejtpërdrejtë të Kushtetutës nga ana e gjyqësorit rus, sikundër dhe ndikimin që kanë pasur në këtë aspekt takimet, konferencat, seminaret dhe tubimet tjera të përbashkëta në mes të juristëve rusë dhe atyre perëndimorë me qëllim të këmbimit të përvojave në lëmin e konstitucionalizmit modern).

116 Ibid.

117 Sovjeti Suprem i ish-Republikës Socialiste Sovjetike të Rusisë ka qenë organi suprem i pushtetit në kohën e komunizmit, kurse në vitet 1990-1993 ka shërbyer si parlament i përhershëm. U shpërbë me dekretin presidencial të **Boris Jelcinit** në krizën e thellë të vitit 1993, kur edhe u themelua Parlamenti i Rusisë që përbëhej nga Duma dhe Këshilli i Federatës. Kjo përbërje ekziston edhe sot në Federatën e Rusisë.

118 Për zhvillimet e **Gjykatës Zorkin** (sipas emrit të presidentit të parë të Gjykatës), përkatësisht për konfliktin në mes të Presidentit B. Jelcin dhe Parlamentit, deri në shpërbërjen e këtij të fundit me dekretin presidencial të datës 22 shtator 1993, shih më shumë Herbert Hausmaninger, "Towards a New Russian Constitutional Court". *Cornell International Law Journal* Volume 28 Issue 2 Spring 1995 fq. 349-386 në fq. 361-366; Jon M. Rodeback, "The Russian Constitutional Court: A Third Branch of the Russian Federal Government. *Sigma: Journal of Political and International Studies* Volume 12 Issue 1 (1994) fq. 1-11 në fq. 6-7.

të Presidentit **Boris Jelcin** në tetor të këtij viti, situatë që zgjati deri në shkurt të vitit 1995. Në ndërkohë, Presidenti **Boris Jelcin** mendonte që të bartë kompetencat e kontrollit kushtetues në Gjykatën Supreme, mirëpo një gjë e tillë nuk ndodhi.[119] Një rezistencë e e theksuar ndaj pavarësisë së **GJKFR**, në vitet e para formative, në literaturë shpjegohet me faktin se **Boris Jelcin** nuk ishte jurist dhe nuk kuptonte se pushteti duhet të ndahet dhe të balansohet në mes të organeve, personave dhe institucioneve të caktuara me kushtetutë dhe ligj.[120]

Me Kushtetutën e re të vitit 1993 u ndryshuan në mënyrë të dukshme kompetencat e GJKFR-së. Një ligj i ri kushtetues për **GJKFR**-në u miratua një vit më vonë, më 1994. **Kushtetuta e Federatës së Rusisë** (1993) në nenin e saj 10 të kapitullit 1 ["Bazat e Sistemit Kushtetues"] flet për pushtetin gjyqësor si një prej tre pushteteve të ndara dhe të pavarura, i cili e ndan drejtësinë në Federatën e Rusisë. Në nenet 118-129 të kapitulli i 7-të ["Pushteti Gjyqësor"] të Kushtetutës flitet në mënyrë të veçantë për sistemin gjyqësor si tërësi. Ky kapitull përcakton strukturën dhe kompetencat e të gjitha gjykatave në Rusi, llojet e tyre, si dhe statusin e gjyqtarëve dhe parimet e punës së tyre. Sistemi gjyqësor në Rusi nuk përcaktohet vetëm me Kushtetutë, por edhe me ligje kushtetuese dhe me ligje tjera federale.

Në mesin e këtyre ligjeve më të rëndësishme janë:[121]

- Ligji Kushtetues Federal i datës 31 dhjetor 1996 Nr. 1-FKZ "Mbi Sistemin Gjyqësor në Federatën e Rusisë" ; dhe
- Ligji Kushtetues Federal i datës 21 korrik 1994 Nr.1-FKZ "Mbi Gjykatën Kushtetuese të Federatës së Rusisë" (me amendamentet dhe plotësimet e vitit 2001).

Sikundër shihet, **GJKFR-ja** bën pjesë në kuadër të sistemit gjyqësor, si një gjykatë e specializuar me juridiksion të veçantë, juridiksion që përcaktohet me Kushtetutë dhe me ligj të veçantë kushtetues. Si pjesë e sistemit gjyqësor rus, **GJKFR-ja** paraqet një organ të specializuar që kryen kontrollin kushtetues në mënyrë autonome dhe pavarësisht nga gjykatat dhe organet tjera.[122] Procedura para Gjykatës rregullohet në mënyrë autonome me rregullat e brendshme.[123]

Në vijim për sa më sipër, Kushtetuta e vitit 1993 ka vetëm një nen, nenin 125 ["Pushteti Gjyqësor"], i cili i dedikohet **GJKFR-së**. Ky nen flet për përbërjen, juridiksionin dhe palët e autorizuara. Për dallim nga neni 165 i Kapitullit 21 ["Sistemi Gjyqësor i Federatës së Rusisë] të Kushtetutës së vitit 1978,[124] i cili definonte **GJKFR** si organin më të lartë gjyqësor për mbrojtjen e rendit kushtetues, ky definim tani

---

119 Jane Henderson, Op. Cit. fq. 152.

120 Ibid., fq. 165 (ku autori thekson se kjo traditë e respektimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese ka nisur me **Mihajl Gorbaçovin** (-1990-1991), ka vazhduar me **Vladimit Putinin (2000-2008)** dhe me **Dimitry Medvedev** (2008-2012) nga shkaku që këta tre presidentë, për dallim nga Boris Jelcin (1991-1999), kanë qenë juristë dhe e kanë kuptuar rolin dhe rëndësinë e respektimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese).

121 Elena A. Kremyanskaya, Tamara O. Kuznetsova amd Inna A. Rakitskaya, *Russian Constitutional Law* (Cambridge Scholars Publishing: Newcastle upon Tyne, 2015) fq. 170-180 (diskutimi analitik mbi dispozitat kushtetuese dhe ligjore lidhur me sistemin gjyqësor në Rusi, strukturën, kompetencat dhe historikun e zhvillimit të tij) dhe fq. 181-194 (analiza e Gjykatës Kushtetuese, punës, organizmit dhe strukturës së saj, rregullave të brendshme të punës si dhe natyrës dhe llojeve të vendimeve të Gjykatës).

122 Cf. nenin 118. 2 i Kapitullit 7-të ["Pushteti Gjyqësor"] të Kushtetutës që thotë se [...]"pushteti gjyqësor ushtrohet përmes procedurave kushtetuese, civile, administrative dhe penale", lidhur me nenin 1 të Kapitullit I ["Dispozitat e Përgjithshme"] të Ligjit Kushtetues "Mbi Sistemin Gjyqësor në Federatën e Rusisë" (19994), i cili e definon Gjykatën Kushtetuese "[...] si një trup gjyqësor që ushtron kontrollin gjyqësor kushtetues në mënyrë të pavarur përmes procedurave kushtetuese".

123 *Regulations of the Constitutional Court of the Russian Federation of March 1, 1995 No. 2-1/6* (Last edition of 10-11-2016). Në internet: http://cis-legislation.com/document.fwx?rgn=16780 (shikuar në prill 2017); Për komente, shih në Jane Henderson, Op. Cit. në fq. 154.

124 Kushtetuta e vitit 1978 e ish-republikës Socialiste Federative Socialiste të Rusisë (RSFSR) ka qenë në fuqi deri më 1993 kur me referendum e 12 dhjetorit 1993 u miratua kushtetuta që aktualisht gjendet në fuqi në këtë vend. Gjatë kësaj kohe, Kushtetuta e ish-RSFR-së e vitit 1978 është amendamentuar mbi treqind herë. Gjykata Kushtetuese e RSFSR është themeluar me amendamentet e vitit 1991 në Kushtetutën e vitit 1978. Cf. për këtë më shumë në analizën e detajuar të këtyre ndryshimeve në Dr. Ninel S. Krylova , "The New Constitution of Russia: Main Principles and Features" . *Akron Law Review* Vol. 27 No. 3 (Winter/Spring, 1994) fq. 397- 406 në fq. 397.

bëhet vetëm për dy gjykatat tjera më të larta në kuadër të sistemit gjyqësor rus: nenet 126 dhe 127 e definojnë Gjykatën Supreme si organin më të lartë gjyqësor të juridiksionit civil, administrativ dhe penal kurse Gjykatën e Lartë të Arbitrazhit si organin më të lartë gjyqësor për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ekonomike. Kushtetuta e vitit 1993 tani flet për çështjet kushtetuese që bien në juridiksionin konkret të **GJKFR-së**, pa e definuar fare pozitën e saj kushtetuese siç kishte bërë më herët, duke e lënë kështu mundësinë që ky juridiksion të mund të përcaktohet edhe më ligjin kushtetues përkatës. Kështu, paragrafi i parë i nenit 125 të Kushtetutës tregon se **GJKFR-së** përbëhet prej 19 gjyqtarëve, kurse paragrafi në vijim flet për palët e autorizuara për të vënë në lëvizje procedurën pranë Gjykatës. Si palë të autorizuara, në vartësi të çështjeve që ngrihen, paraqiten të gjitha organet qendrore të pushtetit, një numër i caktuar i deputetëve rusë ose i anëtarëve të Këshillit të Federatës, anëtarët e Federatës përmes organeve të tyre legjislative dhe ekzekutive, Gjykata Supreme dhe Gjykata e Lartë e Arbitrazhit dhe, krejt në fund, si palë e autorizuar janë individët kur flitet për të drejtat e liritë e tyre kushtetuese.

Paragrafët tjera në vijim, paragrafët 5-7 të nenit 125 të Kushtetutës së vitit 1993, kryesisht flasin për çështjet që bien në juridiksionin konkret të **GJKFR-së** në lëmenjtë që kanë të bëjnë, **inter alia**, me:

- vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve të Presidentit, të Këshillit Federal, Dumës Shtetërore dhe të Qeverisë;
- vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktivitetit legjislativ dhe aktivitetit tjetër të njësive federale dhe organeve të tyre;
- vlerësimin e kushtetutshmërisë së marrëveshjeve të lidhura në mes të organeve të pushtetit në nivel federativ, si dhe të kushtetutshmërisë së marrëveshjeve të lidhura në mes të Federatës dhe organeve të pushtetit të njësive federale dhe të atyre të lidhura në mes të organeve të pushtetit në nivel jofederal;
- vlerësimin e kushtetutshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare të Federatës së Rusisë para hyrjes së tyre në fuqi;
- zgjidhjen e konfliktit për kompetencë në mes të organeve qendrore federale, në mes tyre dhe organeve të njësive federale të pushtetit, si dhe në mes të organeve qendrore supreme të pushtetit në njësitë federale;
- vendosjen për ankesat individuale lidhur me cenimin e të drejtave dhe lirive individuale në një rast konkret që pritet të zgjidhet përmes zbatimit të një ligji apo që është zgjidhur me zbatim të një ligji që pohohet se cenon të drejtat e liritë individuale;
- interpretimin e Kushtetutës së Federatës së Rusisë;
- dhënien e një mendimi këshillëdhënës lidhur me respektimin e procedurës së akuzimit të Presidentit të Federatës së Rusisë për tradhti të lartë apo për kryerjen e krimeve tjera serioze; dhe
- ndërmarrjen e iniciativës legjislative në kuadër të juridiksionit të vet.

Duhet të theksohet se **GJKFR-ja** fokusohet kryesisht në çështjet juridike, pra në çështjet normative, jo në ato faktike apo të faktit.[125] Këto të fundit bien në juridiksion ekskluziv të gjykatave të kompetencës së përgjithshme (gjykatave të rregullta).[126] Përveç kësaj, skundër shihet nga paragrafi i fundit i nenit 125 të Kushtetutës, **GJKFR-ja** ka edhe iniciativë legjislative, diçka që nuk gjendet gjetiu (përveç në rastin e gjyqësisë kushtetuese në ish-Jugosllavi). Ky juridiksion i çuditshëm, i ngelur si relikt nga e kaluara komuniste, sigurisht që bie ndesh me parimin e ndarjes së pushteteve, përkatësisht se iniciativa legjislative paraqet një ndërhyrje të hapur të gjyqësisë kushtetuese në fazën kryesore të përpilimit të ligjeve dhe shprehjes së vullnetit të sovranit.

---

[125] Cf. nenin 3 paragrafin 2 të Kapitullit I ["Autorizimet e Gjykatës Kushtetuese"] të **Ligjit Kushtetues mbi Sistemin Gjyqësor në Federatën e Rusisë** (1994), i cili përcakton se: [...] Gjykata Kushtetuese e Federatës së Rusisë vendos ekskluzivisht për çështje ligjore".

[126] Cf. nenin 3 paragrafin 3 të Kapitullit I ["Autorizimet e Gjykatës Kushtetuese"] të **Ligjit Kushtetues mbi Sistemin Gjyqësor në Federatën e Rusisë** (1994), i cili përcakton se: [...] Në vijim të zhvillimit të procedurave kushtetuese, Gjykata Kushtetuese e Federatës së Rusisë duhet të rezervohet nga vendosja lidhur me rrethanat konkrete të vërteta të rastet si dhe të kryej hetime lidhur me rastet kur kjo ka të bëjë me kompetencat e gjykatave apo organeve tjera".

Juridiksionin e **GJKFR-së** duhet gjykuar duke marrë parasysh Kushtetutën në fuqi të vitit 1993 dhe Ligjin Kushtetues të vitit 1994 si më sipër. Kjo do të thotë se juridiksioni i Gjykatës nuk mund të përcaktohet me ligj të zakonshëm por vetëm përmes një ligji që ka natyrë të instrumentit kushtetues. Kjo bëhet e qartë nga redaktimi i paragrafit 3 të nenit 118 të Kushtetutës, ku përcaktohet se themelimi i sistemit gjyqësor të Federatës bëhet përmes Kushtetutës dhe ligjeve kushtetuese. Në vijim të kësaj, juridiksionin e përcaktuar me kushtetutë nuk duhet parë si një juridiksion të shkallës së parë (primar) krahasuar me juridiksionin tjetër që përcaktohet me ligj, siç ndodh në vendet tjera, përfshirë Kosovën, sepse juridiksioni ligjor në rastin rus përcaktohet me ligj që ka natyrë kushtetuese. Kjo ka ndodhur deri më tani në dy raste, përkatësisht me ligji kushtetues për referendumin dhe me ligjin kushtetues për Avokatin e Popullit, të cilët parashikojnë që subjektet e përcaktuara me këto dy ligje mund ta vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese.[127]

Krejt në fund, në kontekstin e juridiksionit të **GJKFR-së**, të përcaktuar me ligj kushtetues, ka nevojë të flitet këtu edhe për debatet që ka zgjuar në kuadër të **Komisionit të Venecias** ndryshimi i fundit i Ligjit Kushtetues Federal i datës 21 korrik 1994 ("Ligji i vitit 1994"), si dhe për rrethanat e këtij amendamentimi. Këto refleksione bazohen në përvojën e autorit të parë të këtij libri, si përfaqësues i parë i Kosovës në **Komisionin e Venecias** dhe si pjesëmarrës në debatet e gjalla lidhur me amendamentimet e 15 dhjetorit 2015 të Ligjit të vitit 1994 ("Amendamentet e vitit 2015").[128] Cila është esenca e këtyre amendamenteve dhe cilat janë shkaqet që shkaktuan nxjerrjen e tyre?

Në korrik të vitit 2015, **GJKFR-së** ka nxjerrë një aktgjykim, Aktgjykimi nr. 21-P/2015 i datës 14 korrik 2015, me të cilin hapi rrugën për nxjerrjen e Amendamenteve të vitit 2015. Ky aktgjykim, në kundërshtim me krejt praktikën e mëhershme të gjyqësisë kushtetuese ruse, ia njohu të drejtën **GJKFR-së** që, në të ardhmen, të mund ta vlerësojë kushtetutshmërinë e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (**GJEDNJ)**. Sipas këtij aktgjykimi, autoritetet vendore ruse mund të refuzonin ekzekutimin e vendimeve të **GjEDNJ-së** në rast se ato binin ndesh me fundamentet e sistemit kushtetues të përcaktuar me **Kushtetutën e Federatës së Rusisë**. Kjo nënkuptonte se çdoherë kur një vendim i **GJEDNJ-së** kërkon zbatim, por sipas interpretimit të **GJKFR-së** bie ndesh me vlerat dhe parimet kushtetuese, kjo gjë duhet të refuzohet sepse **GJKFR-ja**, jo **GJEDNJ**, ka detyrim kushtetues për të siguruar supremacinë (epërsinë) e Kushtetutës. Me këtë qasje, e cila u sanksionua me Amendamentet e vitit 2015, **Rusia** efektivisht mohoi detyrimet e saj ndërkombëtare të marra në vitin 1998. Kjo bëhej me bindjen se bazat e rendit kushtetues rus ishin më të larta se ato të sanksionuara me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (**KEDNJ)**, sikundër që edhe liritë e të drejtat e garantuara me **Kushtetutën e Federatës së Rusisë** janë më të mëdha (më të forta) se ato që ofrohen me **KEDNJ.** Me këtë Rusia efektivisht tregoi se një lloj hegjemonie imperiale ekziston edhe në lëmin kushtetues sepse me këtë hap abrogohet dispozita e nenit 15.4 të **Kushtetutës së Federatës së Rusisë** që marrëveshjeve ndërkombëtare, ku është palë Federata, ua njeh statusin e ligjit të brendshëm me fuqi menjëherë pas Kushtetutës. Në mënyrë të njëjtë, si u pa më sipër, **GJKFR-ja** ka kompetencë për kontrollin kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare vetëm para së ato të hyjnë në fuqi, pra ka të drejtën e kontrollit kushtetues preventiv. Me këtë qasje të re, e cila u bë ligj me Amendamentet e vitit 2015, **GJKFR-ja** jo vetëm që ka të drejtë të bëjë kontrollin represiv kushtetues të **KEDNJ** si një marrëveshje ndërkombëtare, të cilën Federata e ka ratifikuar më 1998, por edhe të vendimeve të gjyqeve ndërkombëtare, në rend të parë të vendimeve të GJEDNJ-së (vendim i së cilës ka shërbyer si pretekst për të nxjerrë aktgjykimin që diskutojmë këtu dhe, me pastaj, Amendamentet e vitit 2015). Kjo përfundimisht i jep të drejtës kushtetuese ruse cilësinë e të drejtës supreme (më të lartë) krahasuar me të drejtën ndërkombëtare, në rend të parë me të drejtën ndërkombëtare që buron nga marrëveshjet ndërkombëtare ku palë është **Rusia**. Si palë e autorizuar me Amendamentet e vitit 2015 për të kërkuar kontrollin kushtetues të

[127] Jane Henderson, Op. Cit. fq. 154.

[128] Në mbledhjen e datës 11 qershor 2014, **Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës** ka ftuar **Kosovën** si shtet sovran dhe i pavarur që t'i bashkohet **Komisionit të Venecias** si anëtar i barabartë me të drejta të plota, pra jo si vëzhgues apo si anëtar me të meta dhe me rezerva, siç po ndodhte ato vite pas shpalljes së pavarësisë së **Kosovës** më datën 17 shkurt 2008. Me vendimin nr. 57/14 të **Qeverisë së Republikës së Kosovës** të datës 12 shtator 2014, autori i parë i këtij studimi, u emërua si përfaqësues i parë i Kosovës në Komision të Venecias, përkatësisht si anëtar i barabartë me të drejta të plota.

vendimeve të gjykatave ndërkombëtare, në rend të parë të vendimeve të **GJEDNJ** (e cila ka qenë shkaku primar i Amendamenteve të vitit 2015), mund të paraqiten organet qendrore federative që kanë autorizime për të përfaqësuar **Rusinë** në botën e jashtme. Këto organe janë në rend të parë Qeveria (Ministria e Drejtësisë kur flitet për përfaqësim pranë organeve gjyqësore ndërkombëtare) dhe Presidenti i Federatës së Rusisë. Reagimi i **Komisionit të Venecias** në këtë qëndrim të njëanshëm dhe unik të **GJKFR-së** ka qenë i ashpër, duke konstatuar, në mbledhjen plenare të qershorit 2016, se Amendamentet e vitit 2015 janë në kundërshtim me **KEDNJ** dhe praktikën e deritanishme kushtetuese të vendeve tjera perëndimore. Si të tilla duhet të ndryshohen, sepse **Federata e Rusisë** është në tërësi përgjegjëse për detyrimet ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe GJKFR-në si organ shtetëror i shtetit rus, e cila nuk mund të ketë rol superior në planin ndërkombëtar dhe të amnistohet nga detyrimi ndërkombëtar që kanë organet e shtetit rus për zbatimin me mirëbesim, **bona fide**, të detyrimeve ndërkombëtare. Së fundi, **GJKFR-ja** ka mundësi që, përmes dialogut me **GjEDNj-në** sipas praktikës së njohur ndërkombëtare dhe evropiane, të zgjedhë mënyrat për vënien në jetë të vendimeve të **GJEDNj-së**, por assesi nuk mund të vendosë sipas metodës "bardh e zi", "bën ose nuk bën" , lidhur me ekzekutimin ose jo të vendimeve të këtij organi gjyqësor panevropian. Me këto qëndrime, **Komisioni i Venecias** e ka bërë të qartë se **GJKFR-ja** ka mundësi të bëjë zgjidhje vetëm në kuadër të rekomandimeve dhe gjetjeve të **GJEDNJ** të dhëna në vendimet e saj. Në asnjë rast, sipas Komisionit, **GJKFR-ja** nuk mund të mohoj të drejtën për kompensim të drejtë të qytetarëve rusë, të cilët kanë fituar rastet pranë **GJEDNJ** (masat individuale); Sa i përket masave të përgjithshme, **GJKFR-ja** mund të propozojë masa të caktuara, të cilat mundësojnë zbatimin e vendimeve të GJEDNJ, jo obstruksionin e tyre. Në këto masa të përgjithshme, sipas Komisionit, hyjnë ndryshimet përkatëse Kushtetuese apo të ligjore, e jo bllokimi i zbatimit të vendimeve në emër të sigurimit të supremacisë (epersisë) së Kushtetutës, përkatësisht të dispozitave mbi bazat e sistemit kushtetues rus dhe të dispozitave mbi të drejtat dhe liritë njerëzore, të cilat assesi nuk mund të jetë më të favorshme se ato të KEDNj-së, kur flitet për garantimin dhe sigurimin e standardeve më të larta mbi të drejtat e njeriut.[129]

Këto shtjellime dhe vërejtje të **Komisionit të Venecias** të miratuara në plenaren e 106-të të marsit 2016, ranë në ujë. **Parlameti i Rusisë** shkoi tutje me miratimin e Amendamenteve të vitit 2015, kurse organet qendror të autorizuara me këto amendamente, Ministria e Drejtësisë, pak muaj më vonë, më 2 shkurt 2016, e apeloi Aktgjykimin e **GJEDNJ** në **GJKFR,** një rast pra që tanimë ishte vendosur në Strasburg. Fjala është për rastin e njohur si **Anchugov & Glatkov kundër Rusisë** i datës 3 korrik 2013[130]. Për të qenë ironia edhe më e madhe, Aktgjykimi i **GJKFR-së** me të cilin në tërësi implementohen Amendamentet e vitit 2015 dhe i jepet fund marrëdhënies toleruese dhe dialoguese të rendit kushtetues rus me rendin juridik ndërkombëtar dhe evropian, ka arsyetimin identik me Aktgjykimin nr. 21-P/2015 të datës 14 korrik 2015 dhe bazohet gjoja në praktikat më të mira të gjykatave kushtetuese evropiane: **Gjermanisë**, **Italisë** dhe **Austrisë**. U mor vesh, ky interpretim është në tërësi keqdashës dhe shpreh tendencën e hapur ruse për moszbatim në të ardhmen të vendimeve të **GJEDNJ**, përveç rasteve kur Rusia konsideron se i shkon për shtati një zbatim i tillë.

Komunizmi shqiptar, nga fillimi deri në fund ngeli stalinist. Kjo do të thotë se nga instalimi i komunizmit shqiptar më 1946, kur u miratua Kushtetuta e parë komuniste shqiptare, e deri më 1989 (tharja e rrënjëve të sistemit komunist në ish-BRSS nga ana e amerikanëve dhe aleatëve të tyre perëndimorë në Evropë), **Shqipëria** ngeli më shumë se komuniste: ajo vazhdoi marrëzinë me diktaturën staliniste edhe

---

[129] Shih qëndrimin refuzues si më sipër të **Komisionit të Venecias** dhe arsyetimin jashtëzakonisht elokuent të tij, në EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION), *INTERIM OPINION ON THE AMENDMENTS TO THE FEDERAL CONSTITUTIONAL LAW ON THE CONSTITUTIONAL COURT OF THE RUSSIAN FEDERATION*. Adopted by the Venice Commission at its 106th Plenary Session (Venice, 11-12 March 2016) on the basis of comments by Mr Bogdan AURESCU (Substitute Member, Romania) Mr Sergio BARTOLE (Substitute Member, Italy) Mr Iain CAMERON (Member, Sweden) Mr Paul CRAIG (Substitute Member, United Kingdom) Mr Wolfgang HOFFMANN-RIEM (Member, Germany) Mr Martin KUIJER (Substitute Member, the Netherlands). *Opinion No. 832/2015*, Strasbourg, 15 March 2016 (**CDL-AD(2016)** 005 Or. Engl.

[130] EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION), *RUSSIAN FEDERATION JUDGMENT No. 12-П/2016 OF 19 APRIL 2016 OF THE CONSTITUTIONAL COURT. Opinion No. 832 / 2016*. Strasbourg, 6 May 2016. CDL-REF (2016) 033 Engl. Only.

pas rënies së saj në vendin e origjinës në ish-BRSS më 1953. Kjo rrethanë, sot e bën më të kuptueshme për lexuesin e zakonshëm pamundësinë e ekzistimit në kushtet shqiptare të ndonjë kontrolli kushtetues në këtë periudhë. **Kushtetuta e Shqipërisë** e vitit 1946, ka qenë një kushtetutë në tërësi e ngjashme me atë sovjetike, e bazuar në ideologjinë marksiste–leniniste. Autoritetet shqiptare, njëjtë si në ish-BRSS në kohën e **Stalinit**, por edhe më vonë, e shihnin konstitucionalizmin perëndimor si një instrument të mbajtjes së eksploatimit të proletariatit nga ana e klasës së pasur dhe refuzonin në mënyrë kategorike çdo parim të konstitucionalizmit modern që ka të bëjë me ndarjen e pushtetit, sundimin e ligjit, demokracinë dhe respektimin e të drejtave dhe lirive njerëzore dhe të minoriteteve.

Përveç këtij elementi ideologjik të theksuar, në **Shqipërinë** e pas Luftës së Dytë Botërore, ka ekzistuar një shoqëri gjysmë-analfabete dhe tribale, e cila, siç e thotë **Ismail Kadare** te **Nga një dhjetor në tjetrin** (1991), ka jetuar nën një diktaturë vetanake, krahas asaj shtetërore, si pasojë e fenomenit mjaft të përhapur mesjetar të gjakmarrjes ku njerëzit nuk kanë guxuar të dalin nga shtëpitë e tyre nga frika e vrasjes prej gjakmarrësve. Ky faktor shtesë dhe rëndues e bën të pakuptimtë çdo hulumtim për ekzistimin e ndonjë ideje reale për kontroll kushtetuese në kushtet shqiptare të kohës. Kjo nënkupton se kontrolli i kushtetutshmërisë në **Shqipëri**, si dhe studimi i tij, kanë kuptim vetëm nëse mendohet për periudhën pas rënies së komunizmit dhe hapjes ndaj botës të shtetit shqiptar. Çdo gjë para kësaj periudhe është një errësirë, mesjetë shqiptare **sui generis**. Në kuptim të kontrollit kushtetues modern perëndimor, ashtu siç e njohim sot, situata nuk është më e mirë edhe gjatë kohës ndërmjet dy luftërave botërore dhe pas pavarësimit të Shqipërisë më 1912.[131] Thënë shkurt, në rastin e **Shqipërisë**, nuk mund të flitet për fillet e ndonjë kontrolli gjyqësor, qoftë edhe të një kontrolli politik të kushtetutshmërisë, në kohën para rrënimit të komunizmit.

Historia e krijimit të **Gjykatës Kushtetuese të Republikë së Shqipërisë** (GJKSH) nuk dallon nga historia dhe arsyet e themelimit të gjykatave kushtetuese në vendet ish-komuniste. Siç u pa nga trajtimi ynë i mësipërm, në kohën e universit komunist evropian kanë ekzistuar vetëm dy gjykata kushtetuese: në ish-Jugosllavi dhe në **Poloni**, kurse në Çekosllovaki ideja e themelimit të saj, e sanksionuar me amendamentet kushtetuese të vitit 1968, ngeli një letër e vdekur pa asnjë efekt real deri njëzet e tri vjet më vonë. Kjo nënkupton se pas vitit 1989 dhe kolapsit të komunizmit në përmasa botërore, të gjitha vendet ish-komuniste kanë synuar që të kopjojnë sa më shumë dhe në mënyrë sa më besnike vendet perëndimore të **Evropës** dhe përtej. Në këtë kopjim hyn edhe përsëritja në tekstet e tyre kushtetuese të teorive dhe përvojave të demokracive tradicionale perëndimore, në mesin e të cilave hyjnë, pa asnjë dyshim, teoritë mbi rolin dhe rëndësinë e kontrollit kushtetues të çdo autoriteti publik si dhe zgjidhjet e mekanizmave të njëjtë institucionalë për vënien në jetë të këtij kontrolli kushtetues. Shumica e vendeve ish-komuniste zgjodhën kontrollin kushtetues të **modelit evropian/kelsenian** ku ekziston një gjykatë e ndarë kushtetuese, e cila ka juridiksion të qartë dhe nuk i përket pushtetit gjyqësor, por, përkundrazi, kontrollon edhe aktivitetin e këtij pushteti. **Shqipëria** nuk bën përjashtim në këtë aspekt: legjislacioni mbi **GJKSH** u miratua më 1992, me të cilin qartë u përcaktua juridiksioni, vendi dhe pozita e kësaj gjykate në sistemin kushtetues shqiptar. Kjo u bë, njëjtë si me rastin rus, para se të miratoheshin ndryshimet kushtetuese në **Kushtetutën e RPS të Shqipërisë**, e cila formalisht akoma ishte në fuqi që nga koha e komunizmit stalinist shqiptar, përkatësisht që nga vitit 1976. Njëjtë si me rastin e **Federatës së Rusisë**, mosekzistimi i një teksti të spastruar dhe të ri të Kushtetutës nacionale, nuk e pengoi Shqipërinë që t'i hynte punës për nxjerrjen e legjislacionit përkatës me qëllim të themelimit të Gjykatës Kushtetuese. Ta shohim nga afër si ka ndodhur ky proces.

*Në vijim të themelimit të **Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë**, dy ligje janë të një rëndësie të madhe:* ***Ligji nr. 7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore*** **kushtetuese" i datës 29 prill 1991 (Ligji nr. 7491)**; dhe **Ligji nr. 7561, datë 29.04.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr. 7491, datë**

[131] Carna Pistan, "La justiia costituzionale nei Paesi dell'Europa centro-orientale (Albania, Macedonia, Serbia, Montenegro, Republica Ceka, Slovacchia, Romania, Bielorossia, Ucraina)". Në Luca Mezzetti (ed.), *SISTEMI E MODELLI DI GUISTIZIA COSTITUZIONALE* (CEDAM: Padova, 2011) fq. 181-291, në. fq. 183.

29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" (Ligji nr. 7561). Sipas nenit 45 të Kreut IV ["Dispozitat e Fundit"] të Ligjit nr. 7491 shfuqizohet Kushtetuta e RPSSH-së e miratuar më 28 nëntor 1976, së bashku me ndryshimet e saj të mëvonshme, kurse sipas neneve 17-28 të Ligjit nr. 7561 krijohet, për herë të parë në historinë kushtetuese të Shqipërisë, baza juridiko–kushtetuese për themelimin e Gjykatës Kushtetuese sipas modelit **evropian/kelsenian**. Para se të flasim për **Ligjin nr. 7561** dhe dispozitat e tij për të, le të shikojmë pak si janë zhvilluar ngjarjet në **Shqipëri** në këtë kohë deri të miratimi i Kushtetutës aktuale më 1988, e cila disa herë është ndryshuar (përfshirë këtë vit, më 2017, si pasojë e procesit të "vetingut shqiptar").

Tranzicioni shqiptar ka pasur dy cilësi: e para, ai ka qenë një tranzicion i nisur dhe kontrolluar nga regjimi ish-komunist në kuptimin që, duke parë frikën nga përmbytja, regjimi nisi koncesionet dhe kompromiset politike me partitë në krijim e sipër gjatë viteve 1989-1990; e dyta, kushtetutëbërja në rastin shqiptar ka qenë e dhimbshme dhe e stërzgjatur, përkatësisht ndër më të stërzgjaturat në krejt ish lindjen komuniste. Kjo ka ndodhur vetëm më 28 nëntor 1998, me rastin e tetëdhjetë gjashtë vjetorit të pavarësisë së Shtetit shqiptar. Në kohën nga rrëzimi i sistemit njëpartiak komunist, në mars të vitit 1991, e deri me nxjerrjen e **Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, më 28 nëntor 1998, e cila aktualisht është në fuqi (Kushtetuta e vitit 1998), vendi është qeverisur me Ligjin nr. 7491.**[132] Ky ligj, në fakt, është cilësuar si kushtetutë e vendit dhe ka shërbyer si bazë juridiko-kushtetuese për nxjerrjen e ligjeve tjera kushtetuese, përfshirë edhe Ligjin 7651.

Në nenin 17 i Ligjit nr. 7561, **GJKSH** definohet [...] si autoriteti më i lartë, që mbron dhe garanton respektimin e Kushtetutës dhe të legjislacionit, si dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës [...]". Nenet tjera në vijim, nenet 18-28, të Ligjit nr. 7561 flasin për çështjet si në vijim:

- për strukturën dhe mënyrën e punës së Gjykatës (neni 19);
- mënyrën dhe kushtet për zgjedhjen e gjyqtarëve, betimin, mandatin, si dhe konfliktin e interesit (nenet 20-22);
- mënyrën e mbarimit të mandatit të gjyqtarit (neni 23);
- kompetencat dhe palët e autorizuara për vënien në lëvizje të e Gjykatës (nenet 24-25);
- mënyrën e vendosjes, efektin dhe natyrën juridike të vendimeve të Gjykatës (nenet 26-27); dhe, së fundi;
- bazën për organizimin e brendshëm dhe funksionimin e Gjykatës sipas një ligji të veçantë që duhet të nxirret me qëllim të rregullimit të procedurës së zgjidhjes së çështjeve si dhe për çështjet e tjera që kanë të bëjnë me jetën dhe punën e saj.

Në kuadër të kompetencave të saj të përcaktuara me Ligjin nr. 7651, ajo ka pasur këto kompetenca:

- interpretimi i Kushtetutës dhe i ligjeve kushtetuese shqiptare (Kushtetuta në atë kohë nuk ka ekzistuar si një tekst formal, por me të është nënkuptuar Ligji nr. 7491 si më sipër);
- kontrolli abstrakt i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së ligjeve dhe akteve tjera nënligjore;
- kontrolli kushtetues i marrëveshjeve ndërkombëtare ku Shqipëria paraqitet si palë, para ratifikimit të tyre, si dhe kontrollin e pajtueshmërisë së ligjeve me normat e gjithëpranuara të së drejtës ndërkombëtare dhe me marrëveshjet ndërkombëtare ku Shqipëria paraqitet si palë;
- zgjidhja e konfliktit për kompetencë në mes të organeve qendrore si dhe në mes tyre dhe organeve të pushtetit lokal;
- vendosja për kushtetutshmërinë e partive politike dhe ndalimin e tyre;
- vendosja lidhur me ligjshmërinë e zgjedhjes së Presidentit të Republikës dhe lidhur me referendumin popullor, duke bërë shpalljen e rezultatit përfundimtar të tyre;
- shqyrtimi i akuzave penale kundër Presidentit të Republikës;

[132] Për këtë periudhë, shih studimin elokuent dhe shumë të detajuar të Levent Gonenc, *PROSEPCTS FOR CONSTITUTIONALISM IN POST-COMMUNIST COUNTRIES* (MARTINUS NIJHOFF PUBLISHERS: The Hague, London and New York, 2002) fq. 150-155.

- vendosje lidhur me ankesat kushtetuese të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre me akte të paligjshme;
- vendosja për pezullimin e ligjit dhe të akteve tjera juridike kur çmon se bien ndesh me Ligjin nr. 7491;
- marrjen e masave të përshtatshme për çështjet që gjykon;
- vendosjen për njohjen dhe garantimin e të drejtës individuale kur konstatohet shkelja e saj, ndreqjen e pasojave dhe kompensimin e dëmit të shkaktuar;
- vendosjen për anulimin, shfuqizimin dhe ndryshimin e vendimit individual me të cilin është cenuar e drejta kushtetuese e personit.

Kushtetuta e vitit 1998, aktualisht në fuqi me shumë amendamentime që ka pasuar nga viti 1998, ka dispozita pak më të ndryshme lidhur me **GJKSH**. Edhe tani, ajo është e ndarë nga sistemi gjyqësor i rregullt dhe ka dispozita të veçanta për të. Pjesa e tetë ["Gjykata Kushtetuese"] e Kushtetutës i dedikohet vetëm asaj me nenet 124-134. Tani ajo definohet më ndryshe sepse mbrojtja dhe garantimi i ligjshmërisë nuk janë tipare të saj definuese por vetëm zgjidhja e mosmarrëveshjeve kushtetuese dhe interpretimi përfundimtar i Kushtetutës (neni 124 para.1 i Kushtetutës). Për të realizuar këtë rol të definuar me Kushtetutë, kërkohet plotësimi i dy kushteve thelbësore: e para, norma që është objekt interpretimi nga ana e Gjykatës duhet të jetë e paqartë dhe kundërthënëse dhe për këtë arsye ekziston një mosmarrëveshje kushtetuese; dhe, e dyta, duhet të ekzistojë një lidhje e ngushtë në mes të normës kushtetuese që interpretohet dhe mosmarrëveshjeve apo çështjeve të përmbajtura në një apo më shumë akte të autoritetit shtetëror. Këto mosmarrëveshje apo çështje kushtetuese lindin si pasojë e zbatimit të gabuar apo kuptimit të keq të normës natyrës dhe përmbajtjes së normës kushtetuese që është objekt interpretimi kushtetues. Palët e autorizuara në këtë rast janë ato që nuk kanë nevojë të provojnë ekzistimin e një interesi subjektiv juridik të mbrojtur me kushtetutë, ligje dhe akte tjera juridike por edhe ato palë që duhet ta provojnë ekzistimin e një interesi juridik për një gjë të tillë. Kjo shihet qartë nga formulimi i nenit 134 i Kushtetutës që flet për këto dy lloje të palëve të autorizuara.[133]

Veprimi i **GJKSH**, sikundër shihet, nuk kufizohet vetëm në rolin e saj klasik të shpalljes së një ligji apo norme si jo kushtetuese. Përveç kësaj, ajo bën, tipike kjo për sistemin **evropian/kelsenian,** ku bën pjesë edhe Shqipëria, edhe shqyrtimin e legjitimitetit kushtetues të ligjeve dhe akteve tjera juridike, e kjo do të thotë interpretim i tekstit të Kushtetutës së vendit. Me këtë veprim Gjykata i shpërfaq parimet dhe urdhrat që janë me disa kuptime apo të paqarta në vetë tekstin kushtetues. Me këtë veprim nuk synohet krijimi i normave të reja, por qartësimi dhe saktësimin i atyre ekzistuese nga ana e Gjykatës, gjithnjë me kërkesën e subjekteve të autorizuara. Këtu objekt kontrolli kushtetues nuk është ligji, por norma kushtetuese e shikuar si një pjesë e një tërësie harmonike të parimeve dhe normave të përmbajtura në tekstin kushtetues.

Realizimi i këtij roli të përshkruar si më sipër bëhet përmes ekzekutimit të kompetencave konkrete të përcaktuar me nenin 131 të Kushtetutës. Kompetencat konkrete, pra të drejtat dhe autorizimi kushtetues i Gjykatës për të vendosur lidhur me një çështje kushtetuese, sipas paragrafit të parë të këtij neni, kanë të bëjnë me vendosjen për:

"[...]a) pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, siç parashikohet në nenin 122;

b) pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën para ratifikimit të tyre;

c) pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare;

ç) mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore;

[133] Shih më shumë punimin e shkëlqyer të Brunilda Bara / Jonad Bara, "Constitutional Court and Constitutional Review in Albania. A historical and institutional overview". *Vienna Journal on International Constitutional Law* Vol. 7 Issue 2 (June 2013) fq. 214-238 në fq. 219- 221 & 229.

d) kushtetutshmërinë e partive dhe të organizatave të tjera politike, si dhe të veprimtarisë së tyre, sipas nenit 9 të kësaj Kushtetute;

dh) shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës dhe vërtetimin e pamundësisë së ushtrimit të funksioneve të tij;

e) çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës, të deputetëve, të funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre.

ë) kushtetutshmërinë e referendumit dhe verifikimin e rezultateve të tij;

f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në kushtetutë".

Në paragrafin e fundit të këtij neni, i cili si tërësi operacionalizon rolin e Gjykatës ashtu siç definohet me nenin e sipërcekur 124.1 të Kushtetutës, thuhet se ky organ ka kompetencë për kontrollin kushtetues të rishikimit të Kushtetutës vetëm sa i përket aspektit procedural të rishikimit të saj. Në rastin e **Kosovës**, siç do të shihet kur të flasim në kapitujt përkatës për rastin e **Kosovës**, Gjykata ka mundësi që të bëjë kontrollin kushtetues të amenadamenteve kushtetuese, si në aspektin procedural ashtu dhe në atë përmbajtjesore. Zgjidhja kushtetuese shqiptare, në fakt, është më e përhapur dhe shkon konform parimit që thotë se një gjykatë kushtetuese nuk mund të jetë veçse ligjvënës negativ, pra nuk krijon, në parim, norma të reja kushtetuese dhe ligjore duke e ruajtur respektimin e juridiksionit të organit përfaqësues.

Sikundër mund të vërehet, nga kompetencat e GJKSH është hequr e drejta dhe autorizimi i saj për t'u vënë në lëvizje **sua sponte**, me vetiniciativë.

Ukraina, një vend në luftë për vetëmbrojtje nga agresioni shtetëror rus që nga shkurti i vitit 2014, është vendi i fundit që trajtojmë në këtë kapitull. U mor vesh, rendi alfabetik në gjuhën shqipe e sjell gjyqësinë kushtetuese ukrainiane në fund të trajtimit tonë, këtë vend në të cilin që nga aneksimi agresiv rus i Krimesë më 18 mars 2014, po zhvillohet beteja e ashpër për zgjerimin e kufijve civilizimit evropian më lart në verilindje të Rusisë.

Zhvillimi i kushtetutshmërisë në këtë vend ka qenë i mundimshëm, njëjtë si në rastin e Shqipërisë, ashtu që deri më 1996 nuk pati një kushtetutë të shkruar por një mori ligjesh kushtetuese që rregullonin aspekte të ndryshme kushtetuese lidhur me ndarjen e pushtetit dhe rolin e pozitën e re të individit në shoqërinë postkomuniste ukrainase. Këto ligje kushtetuese normonin, në rend të parë, pozitën e Presidentit dhe të Parlamentit të këtij vendi, duke ia njohur institucionit të parë një pozitë pushteti më të theksuar në krahasim me institucionet tjera të pushtetit[134]. Kjo bëhej për dy arsye: e para, Presidenti, pas themelimit të institucionit të njëjtë në nivel të ish-BRSS-së në kohën e Presidentit **Mihail Gorbaçov**, shërbente si një lloj simboli dhe krenarie nacionale e **Ukrainës** që po synonte pavarësimin e saj nga **Moska**; e dyta, pas shpërbërjes së ish-BRSS-së në fund të vitit 1991, institucionet e **Ukrainës** nuk ishin të afta për të luajtur rolin e tyre të ri në kushtet socio-politike dhe ekonomike krejtësisht tjera nga ato të kohës së komunizmit, nisur nga fakti se, si të tilla, ato ishin krijuar gjatë komunizmit me qëllim të luajtjes së rolit të tyre në kuadër të ish-BRSS-së. Në këto kushte, institucioni i presidentit të **Ukrainës** u krijua për të luajtur rolin e forcuesit të institucioneve të reja të Republikës.[135]

---

[134] Për ligjet kushtetuese me të cilat normohej forma dhe përmbajtja e pushtetit në Ukrainë, zgjidhjet institucionale për shfaqjen këtij pushteti, si dhe kronologjitë e nxjerrjes së këtyre ligjeve gjatë viteve 1990-1996, shih më shumë deri në detaje në Levent Gonenc, op. cit. fq. 173-178.

[135] Kataryna Wolczuk, Ukraine: Tormented Constitution-Making . Në Jan Zielonka (ed.), *Democratic Consolidation in Eastern Europe. Volume I. Institutional Ingineering* (Oxford University Press: Oxford, 2001) fq. 244-245.

Miratimi i Kushtetutës më 1996, shënon një fazë të re në zhvillimin e konstitucionalizmit në këtë vend, përfshirë këtu edhe zhvillimin e gjyqësisë kushtetuese. Deri në këtë vit ka ekzistuar një lloj sistemi i çuditshëm parlamentar i qeverisjes, i tipit sovjetik, kurse, pas miratimit të Kushtetutës në qershor të vitit 1996, nisi delimitimi i pushteteve dhe ndarja e balansimi i tyre, ani se i paqartë sipas standardeve perëndimore. Kjo paqartësi u reflektua edhe në luftën për pushtet në mes të Presidentit dhe Parlamentit. Tensioni në mes të këtyre dy institucioneve shtetërore u reflektua në rend të parë në punën e **Gjykatës Kushtetuese të Ukrainës (GJKUk)**, e themeluar pak muaj pas aprovimit të Kushtetutës së vitit 1996. Në fakt, vendimi i saj i parë kishte të bënte pikërisht me arbitrimin e mosmarrëveshjeve në mes të këtyre dy institucioneve shtetërore, të cilat në mënyrë të vazhdueshme dërgonin raste të cilat kishin të bënin me ushtrimin e funksionit bazik të kësaj gjykate, përkatësisht me interpretimin e Kushtetutës dhe sigurimin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve tjera juridike më të ulëta se ligji. Kjo kompetencë, e përcaktuar me nenin 13 të Kushtetutës, kontestohej në vazhdimësi nga komunistët ukrainas dhe forcat tjera të majta, të cilat mendonin, sipas logjikës së vjetër të sundimit komunist të sovjetëve supreme, se vetëm Parlamenti mund të bënte interpretimin e ligjeve dhe përputhshmërinë e tyre me Kushtetutën. Sipas tyre, Parlamenti duhej ta kishte këtë të drejtë meqë ishte organi suprem i pushtetit[136]. Ky definim i parlamentit si organ suprem i pushteit ekziston akoma në mendjet e disave edhe në **Kosovë** dhe në vendet tjera ish-komuniste, ku ka pasur një praktikë të unitetit të pushtetit që ushtrohej nga kuvendi në emër të klasës punëtore dhe fshatarëve dhe forcave tjera sociale, nën udhëheqjen e partisë komuniste si avangardë e krejt klasës punëtore, fshatarëve dhe shtresave tjera sociale.

GKUk, nga koha e themelimit ka pësuar disa ndryshime në juridiksionin e saj, si dhe në disa aspekte tjera. Juridiksioni përcaktohet përveç me kushtetutë[137] edhe me Ligjin e për Gjykatën Kushtetuese[138]. Kontrolli kushtetues në këtë vend njeh disa forma të manifestimit. Në këto forma përfshihet edhe interpretimi zyrtar i ligjit dhe i normave kushtetuese. Interpretimi i ligjit, me amendamentet e qershorit të vitit 2016, është hequr nga juridiksioni i saj.[139] Kjo do të thotë se tani interpretimi zyrtar ka të bëjë vetëm me interpretimin e normave kushtetuese, jo të ligjit. Ky interpretim i fundit mund të bëhet vetëm në procedurën tjetër të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve, qoftë në një procedurë të kontrollit abstrakt apo në procedurë të kontrollit incidental.

Kontrolli kushtetues i ligjeve dhe i akteve tjera juridike më të ulëta se ligji normohet me nenin 150 të Kushtetutës dhe me nenin 13.1 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Sipas pikës së parë të paragrafit të parë të nenit 150 të Kushtetutës, **GJKUk** vendos lidhur me pajtueshmërinë me Kushtetutën të ligjeve dhe akteve tjera të **Parlamentit të Ukrainës**, të akteve të **Presidentit të Ukrainës**, të akteve të **Këshillit të Ministrave të Ukrainës** dhe, së fundi, të akteve të **Parlamentit të Republikës Autonome të Krimesë**. Kjo e fundit, siç u tha më herët, gjendet nën okupimin rus që nga vitit 2014. Aktet e karakterit politik të Parlamentit nuk mund të jenë objekt i kontrollit kushtetues. Palët e autorizuara për të vënë në lëvizje Gjykatën lidhur me këtë lloj të kontrollit kushtetues përcaktohen me paragrafin e fundit të nenit 150. Ato palë janë: Presidenti, jo më pak se dyzetë e pesë (45) deputetë, Këshilli i Ministrave, Gjykata Supreme, Përfaqësuesi i Autorizuar i Parlamentit të Ukrainës për të Drejtat e Njeriut dhe, së fundi, Parlamenti i Krimesë.

Kontrolli kushtetues, si më sipër, merr disa forma të manifestimit. Ai mund të jetë, sipas Kushtetutës, Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, si dhe vetë praktikës së Gjykatës, **kontroll kushtetues represiv, preventiv, normativ i tërthortë, normativ, kolateral** dhe, së fundi, **kontroll i verifikimit normativ.**[140] Nga shtjellimet tona të deritanishme, është parë qartë se shenja dalluese e gjyqësisë kushtetuese nga gjyqësia e rregullt dhe

136 Ibid. 262-263.

137 Krahaso nenet 147-153 të Kapitullit XII ["Gjykata Kushtetuese"] të Kushtetutës së vitit 1996, me ndryshimet e fundit të datës 2 qershor 2016.

138 Krahaso nenet 13-15 të Kapitullit 2 ["Autoritetet e Gjykatës Kushtetuese të Ukrainës"] të *Ligjit i Ukrainës mbi Gjykatën Kushtetuese të Ukrainës*, me amendamentet e 14 tetorit 2014 . Në internet : http://www.bbcj.eu/law-ukraine-constitutional-court-ukraine/ (shikuar në maj 2017).

139 Neni 147 ["Gjykata Kushtetuese e Ukrainës"] i Kushtetutës: "Gjykata Kushtetuese e Ukrainës vendos lidhur me pajtueshmërinë e ligjeve dhe akteve tjera të Ukrainës me Kushtetutën e Ukrainës dhe ofron interpretim zyrtar të Kushtetutës së Ukrainës si dhe ushtron juridiksion tjetër në pajtim me këtë Kushtetutë".

140 Jean – Pierre Massias, *Droit constitutionnel des Etats d'Europe de l'Est* (Presses Universitaires de France, 1999) fq. 674-675.

nga çdo formë tjetër e ndarjes së drejtësisë është **kontrolli represiv dhe abstrakt i normës**, i cili ushtrohet më së shpeshti në praktikë. Në rastin e **Ukrainës**, ky kontroll ka të bëjë, ngjashëm me vendet tjera të gjyqësisë së njëjtë kushtetuese, me ligjet dhe me aktet juridike të Parlamentit, me aktet e Presidentit, të ekzekutivit (Këshillit të Ministrave), si dhe me aktet e Parlamentit të Krimesë. Sipas interpretimit të **GJKUk**, të kryer me vendimin e saj të datës 23 mars 2002, ajo është kompetente për të ushtruar kontrollin kushtetues jo vetëm ndaj akteve normative, por edhe ndaj atyre individuale të nxjerra nga Parlamenti dhe Presidenti. Kontrolli ka të bëjë si me procedurën e ndjekur për prodhimin e akteve në fjalë ashtu edhe sa i takon vetë përmbajtjes së tyre. Përveç kontrollit represiv, pra përveç kontrollit të ligjeve dhe akteve tjera (normative dhe individuale si më sipër) pas hyrjes së tyre në fuqi, Gjykata bën edhe kontrollin kushtetues të dy kategorive të akteve juridike të përgjithshme. Në kategorinë e parë bëjnë pjesë marrëveshjet ndërkombëtare të cilat ende nuk kanë kaluar ratifikimin në Parlament. Në këtë rast, sipas paragrafit të parë të nenit 151 të Kushtetutës, Gjykata jep një mendim lidhur me pajtueshmërinë me Kushtetutën të marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat janë paraqitur në Parlament për ratifikim. Kategoria e dytë ka të bëjë me draftligjin për rishikim kushtetues në kuptim të nenit 159 të Kushtetutës. Sipas këtij neni, Parlamenti mund ta miratojë draftligjin me të cilin bëhen amendamentimet kushtetuese vetëm pasi të jetë marrë një mendim i Gjykatës lidhur me pajtueshmërinë e këtyre amendamenteve të propozuara me nenet 157 [141]dhe 158[142] të Kushtetutës.

Sipas nenit 61 [‘’Vendimet e Gjykatës Kushtetuese’’] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, **GJKUk** mund të bëjë **kontrollin kushtetues normativ të tërthortë**. Me këtë nënkuptohet situata në të cilën Gjykata gjen se ekziston papajtueshmëria me Kushtetutën e një ligji, norme apo dispozite tjetër të ndonjë akti tjetër juridik, ani se nuk ka qenë objekt i kontrollit kushtetues nga ana e palëve të autorizuara. Ky kontroll bëhet me kusht që papajtueshmëria e tyre ka një ndikim në vendimin apo mendimin e GJKUk lidhur me mospërputhjen me Kushtetutën të një ligji, norme apo dispozite tjetër të ndonjë akti tjetër juridik lidhur me të cilat është vënë fillimisht në lëvizje procedura pranë saj. Në rastin e **kontrollit kushtetues normativ kolateral**, ajo ka autorizim për të vënë në spikamë zbrazësitë ligjore apo mungesën e aktivitetit ligjvënës të Parlamentit në ndonjë çështje konkrete (i ashtuquajturi ometimi legjislativ). Këtë autorizim e ka marrë mbi vete sipas një vendimi të datës 26 shkurt 1998, lidhur me zgjedhjet nacionale, kur ka konstatuar se mungesa e ankesës dhe mjeteve tjera juridike kundër vendimeve të organeve zgjedhore në procesin e zgjedhjeve përbën një ometim legjislativ që duhet përmirësuar. Në fund, **kontroll kushtetues i verifikimit normativ** përcaktohet me paragrafin e fundit të nenit 151 të Kushtetutës dhe ka të bëjë me të autorizimin e GJKUk për të kontrolluar kushtetutshmërinë e zbatimit të nenit 111 [‹›Presidenti i Ukrainës››] të Kapitullit V të Kushtetutës.[143]

---

[141] Kapitulli XIII, neni 157 [“Amendamentimi i Kushtetutës”] i Kushtetutës: “Kushtetuta e Ukrainës nuk mund të amendamentohet nëse amendamentet parashikojnë abrogimin apo kufizimin e të drejtave dhe lirive njerëzore dhe të qytetarit, apo nëse ato janë të orientuara kah likuidimi i pavarësisë apo pandashmërisë territoriale të Ukrainës.
Kushtetuta e Ukrainës nuk mund të amendamentohet në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme apo gjatë shtetrrethimit”.

[142] Kapitulli XIII, neni 158 [“Amendamentimi i Kushtetutës”] i Kushtetutës: “Draft – ligji me të cilin propozohet amendamentimi i Kushtetutës së Ukrainës, i shqyrtuar nga Parlamenti por që nuk ka marrë miratimin, mund t’i paraqitet Parlamentit jo më herët se një vit nga dita e miratimit të vendimit lidhur me këtë draft-ligj.
Në kuadër të autoritetit të tij, Parlamenti i Ukrainës nuk do të bëjë amendamentimin dy herë të dispozitave të njëjta të Kushtetutës”.

[143] Neni 111 i Kapitullit V [‘’Presidenti i Ukrainës’’] të Kushtetutës:
“Presidenti i Ukrainës mund të shkarkohet nga Parlamenti sipas një procedure të **impeachment**-it kundër tij në rastet kur ai apo ajo ka kryer tradhti apo krim tjetër.
Çështja e shkarkimit të **Presidentit të Ukrainës** përmes procedurës së **impeachment**-it niset nga shumica e përbërjes kushtetuese të Parlamentit.
Për të zhvilluar procedurën e hetimit, Parlamenti i Ukrainës themelon një komision të përkohshëm hetimor në përbërjen e të cilit hyjnë një prokuror special dhe hetues special.
Përfundimet dhe propozimet e komisionit të përkohshëm hetimor shqyrtohen në një mbledhje të Parlamentit të Ukrainës.
Atëherë kur ekzistojnë bazat, Parlamenti , me jo më pak se dy të tretat (2/3) e përbërjes së tij kushtetuese, miraton një vendim me të cilin akuzon Presidentin e Ukrainës.
Vendimi për shkarkim të Presidentit të Ukrainës përmes procedurës së **impeachment**-it konsiderohet i miratuar nga Parlamenti nëse për te votojnë jo më pak se tri të katërtat (3/4) e përbërjes së tij kushtetuese, pas shqyrtimit të rastit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të Ukrainës dhe marrjes së mendimit të saj lidhur me respektimin e procedurës kushtetuese të hetimit dhe shqyrtimit të rastit të **impeachment**-it, si dhe pas marrjes së mendimit të Gjykatës Supreme që konstaton se veprimet për të cilat akuzohet Presidenti i Ukrainës paraqesin tradhti apo krim”.

Një autorizim mjaft i rëndësishëm është ai që njihet si **interpretimi zyrtar** i Kushtetutës. Ky autorizim përcaktohet me pikën e dytë të paragrafit të parë të Kushtetutës[144] lidhur me nenin 13.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.[145]Ky aktivitet i GJKUk paraqet një veprimtari kryesore sepse përveç autoriteteve politike (Presidenti, Këshilli i Ministrave etj), qytetarët, të huajt, personat pa shtetësi, si dhe personat juridikë kanë të drejtën e vënies në lëvizje të Gjykatës me qëllim të marrjes së një mendimi zyrtar që interpreton Kushtetutën[146], lidhur me rastet nga neni 13.4 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.[147] Vendimet që jepen në zbatim të këtij autorizimi kushtetues e ligjor nuk kanë për efekt anulimin e ndonjë ligji apo norme si jo kushtetuese.

Me nenin 151 të Kushtetutës, të amendamentuar në qershor të vitit 2016, ankesa individuale mund të ushtrohet edhe ndaj vendimeve përfundimtare gjyqësore më të cilat ankuesi pohon se është cenuar Kushtetuta, por me kusht që ankuesi i ka shterur të gjitha mjetet efektive juridike[148]. Në praktikë, ky cenim i Kushtetutës zakonisht konsiston në shkeljet e të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë. Ky lloj i ankesës individuale quhet **ankesë jo e plotë**, e cila ekziston edhe në disa vende tjera si në **Armeni, Rusi**, **Poloni** etj. Cilësia e kësaj anekse është se ankuesi nuk mund të pohojë se akti individual gjyqësor i cenon të drejtat dhe liritë e tij/saj si pasojë e interpretimit dhe zbatimit jo kushtetues të ligjit, nëse ky ligj vetë nuk është sfiduar në GJKUk për shkak të jo kushtetutshmërisë së tij. Kjo sepse interpretimi i ligjit, cilido që të ketë qenë ai interpretim dhe zbatim, është prerogativë e plotë e gjyqësorit të rregullt. Në rastin e Gjermanisë, Spanjës, ku bën pjese edhe Kosova e disa vende tjera evropiane, ekziston **ankesa e plotë kushtetuese**. Për këtë do të flasim me vonë sërish kur t'i vije radha **Kosovës.** Këtu mjafton të theksojmë se, në rastin e **ankesës së plotë kushtetuese,** objekt i kontrollit kushtetues nuk është vetë ligji, siç ndodhë me rastin e mësipërm të **ankesës jo të plotë kushtetuese**, por jokushtetutshmëria e nxjerrjes së një akti individual (gjyqësor apo tjetër) në bazë të ligjit apo ndonjë akti tjetër të përgjithshëm. Në rastin e **ankesave të plota kushtetuese**, individi arrin anulimin e vendimit individual (gjyqësor apo tjetër), kurse në rastin e **anekses jo të plotë kushtetuese** nuk bëhet anulimi i vendimit (gjyqësor apo tjetër), por vetëm shpallja e ligjit si jo kushtetues dhe e drejta e ankuesit për të rihapur procedurat (gjyqësore dhe tjera), të cilat janë bazuar në zbatimin e ligjit jo kushtetues, i shpallur si i tillë me vendim të gjykatës. Për këtë arsye në praktikën evropiane, ankesa jo e plotë nuk konsiderohet si mjet efektiv kurse ankesa e plotë kushtetuese konsiderohet si mjet efektiv. **Komisioni i Venecias** i ka rekomanduar **Ukrainës** që ta fusë në sistemin e vet kushtetues ankesën e plotë kushtetuese me qëllim të përafrimit të saj me standardet evropiane më të larta për mbrojtjen efektive të të drejtave dhe lirive kushtetuese, ani se **Ukraina** ka marrë notë pozitive lidhur me amendamentimet e Ligjit Kushtetues të vitit 2016, të shkaktuara si pasojë e ndryshimeve kushtetuese në këtë vend të kryera në qershor të vitit qershor të vitit 2016 (siç u theksua më sipër).[149]

---

144 Neni 150.1.2 ["Autoritetet e Gjykatës Kushtetuese të Ukrainës"] i Kushtetutës: "Gjykata Kushtetuese ka autoritet për [...] interpretimin zyrtar të Kushtetutës së Ukrainës [...] ".

145 Me amendamentet e vitit 2016, siç u theksua, Gjykata nuk ka autorizim për të bërë interpretimin e ligjeve, por vetëm të Kushtetutës. Nenin 13.4 i Ligjit si më sipër përmban fjali të njëjtë si neni 150.1.2 i Kushtetutës.

146 Neni 43 ["Subjektet që kanë të drejtë për ankesë kushtetuese me qëllim të marrjes së një mendimi nga Gjykata Kushtetuese e Ukrainës"] i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese: "Subjektet që kanë të drejtën e ankesës kushtetuese për marrjen e mendimit të Gjykatës së Ukrainës në rastin e paraparë me pikën 4 të nenit 13 të këtij Ligji janë shtetasit e Ukrainës, të huajt, personat pa shtetësi dhe personat juridikë".

147 Neni 14.3 ["Autoritetet e Gjykatës Kushtetuese të Ukrainës"] i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese: ["Autoritetet e Gjykatës Kushtetuese të Ukrainës"] i Kushtetutës: "Gjykata Kushtetuese ka autoritet për [...] interpretimin zyrtar të Kushtetutës së Ukrainës".

148 Sipas nenit 94 ["Bazat e Ankesës Kushtetuese"] të Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese të vitit 2014, pra para reformave kushtetuese të qershorit 2014, vetëm interpretimi dubioz (i dyshimtë) i dispozitave të Kushtetutës apo ligjeve të Ukrainës nga ana e gjykatave apo organeve tjera shtetërore ka shërbyer si bazë për të kërkuar me ankesë kushtetuese një interpretim kushtetues, me kusht që pala që ka ushtruar ankesë kushtetuese konsideron se një interpretim i tillë dubioz (i dyshimtë) mund të çoj apo ka çuar në cenimin e të drejtave dhe lirive të tij/saj kushtetuese.

149 EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION), *UKRAINE: OPINION ON THE DRAFT LAW ON THE CONSTITUTIONAL COURT. Adopted by the Venice Commission at its 109th Plenary Session* (Venice, 9-10 December 2016) Strasbourg, 12 December 2016 Opinion No. 870 / 2016 CDL-AD(2016)034 (Or. Engl.) . Paragrafët 33-45.

5.4. Komente dhe pyetje

5.4.1. Ish-Jugosllavia ka qenë vendi i parë komunist që ka futur gjyqësinë kushtetuese më 1963. Kjo gjyqësi kushtetuese është ushtruar në tri nivele, federal, republikan dhe krahinor. Në kuadër të kompetencave të saj ka qenë edhe mbikëqyrja e ligjshmërisë jo vetëm e kushtetutshmërisë. Kushtetutshmëria dhe ligjshmëria në ish-Jugosllavi kanë pasur tri shtresa: federale, republikane dhe krahinore. Në tri këto nivele është ushtruar gjyqësia kushtetuese. Ish-Jugosllavia, megjithatë, ka pasur disa specifika, të cilat e dallojnë nga gjyqësia kushtetuese bashkëkohore e proveniencës perëndimore liberale. Cilat janë ato cilësi që e dallojnë këtë lloj gjyqësie nga gjyqësia kushtetuese e proveniencës liberale perëndimore?

5.4.2. Në territorin e ish-Jugosllavisë janë krijuar disa shtete, në mesin e tyre edhe Kosova. Të gjitha ato, pra ish-republikat jugosllave, përveç Kosovës, festojnë si ditë të gjyqësisë kushtetuese ditën kur janë themeluar gjykatat e para kushtetuese më 1963. Edhe në pikëpamje të kompetencave kanë ruajtur disa kompetenca që i kanë pasur nën ish-Jugosllavi. Për çka bëhet fjalë këtu? Me fjalë tjera, për cilat kompetenca bëhet fjalë në rastin e ish-republikave jugosllave të cilat i kanë ruajtur edhe në kushtetutat e reja të nxjerra pas pavarësimit të tyre të plotë pas shpërbërjes së Shtetit jugosllav?

5.4.3. GJKRSFJ nuk ka pasur në kompetencë të saj vlerësimin e kushtetutshmërisë së kushtetutave republikane dhe krahinore. Në të njëjtën kohë, ajo nuk ka qenë instance e fundit në çështjet kushtetuese. Për çfarë cilësish të kësaj gjykate bëhet fjalë këtu dhe cila ka qenë marrëdhënia e kësaj gjykate me gjykatat kushtetuese republikane dhe krahinore?

5.4.4. Cilat janë dy nga veçoritë e ngjashme në mes të gjyqësisë kushtetuese kosovare dhe asaj të Bosnje-Hercegovinës? Njëra ka të bëjë me historinë e dhunshme të dy vendeve e tjetra me përbërjen e dy gjykatave kushtetuese.

5.4.5. Në esencë, përveç **Bosnje-Hercegovinës**, si pasojë e historisë së saj tragjike dhe gjenocidit kundër popullit boshnjak të shkaktuar nga forcat serbe, zhvillimi kushtetues i ish-republikave tjera jugosllave pak a shumë ka një ngjashmëri të përgjithshme. Nga çka vërehet dhe si manifestohet kjo ngjashmëri?

5.4.6. Ligji Kushtetues mbi Gjykatën Kushtetuese i Republikës së Kroacisë (1999), i cili ka ndryshuar ligjin e njëjtë të vitit 1991, ka paraparë risi të konsiderueshme në punën e **GJKKr** Sipas nenit 63.1 ["Mbrojtja e të Drejtave dhe Lirive Themelore"] të këtij ligji, ankesa kushtetuese mund të paraqitet edhe para se të shteren mjetet tjera juridike, pra në mënyrë të drejtpërdrejtë, nëse pushteti publik nuk ka vepruar në afat të arsyeshëm në mbrojtje të të drejtave dhe lirive njerëzore. Pse është futur kjo dispozitë në sistemin e gjyqësisë kushtetuese kroate?

5.4.7. RFJ në vitin 2002, u transformua në **USMZ.** Sipas Marrëveshjes për **USMZ**, e lidhur në Beograd në mes të **Serbisë** dhe **Malit të Zi** më datën 14 mars 2002, parashikohej themelimi i një gjykate qendrore kushtetuese për tërë territorin e **USMZ**. Kjo gjë nuk u realizua. Pse nuk u bë kjo dhe cilat ishin pasojat e mosformimit të këaj gjykate kushtetuese për tërë territorin e **USMZ**?

5.4.8. Sipas Kushtetutës së Malit të Zi (2007), **GJKMZ** në kuadër të kompetencave të saj e ka edhe kompetencën e përcjelljes së realizimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, si dhe përcjelljen e dukurive jokushtetuese dhe joligjore dhe detyrimin e njoftimit të **Kuvendit të Malit të Zi** për një gjë të tillë. Kjo kompetencë paraqet një relikt nga e kaluara e gjyqësisë kushtetuese jugosllave. A përbën kjo kompetencë një shmangie nga kompetencat klasike të gjykatave kushtetuese që modelohen sipas modelit klasik **kelsenian/evropian**? Nëse po, tregoni arsyet!

5.4.9. Për dallim nga disa prej ish-republikave jugosllave, përfshirë këtu edhe rastin e Kosovës, **GJKMV** nuk ka detyrë që të përcjellë dukuritë e jokushtetutshmërisë dhe joligjshmërisë dhe as që të lajmërojë Kuvendin lidhur me këto dukuri. Çfarë do të thotë kjo në rastin e disa ish-republikave jugosllave?

5.4.10. Në kuadër të kompetencave specifike të **GJKSrb** hyn edhe kompetenca që ka të bëjë me marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare. Në çfarë konsiston kjo kompetencë?

5.4.11. Me termin "krahina" në **Kushtetutën e Serbisë** nënkuptohen **Kosova** dhe **Vojvodina**. Kjo qartë shihet në paragrafin e dytë të Kushtetutës, ku Kosova cilësohet si një autonomi substanciale brenda **Republikës së Serbisë**. Çfarë do të thotë kjo?

5.4.12. Derisa Kushtetuta e Hungarisë e vitit 2011, aktualisht në fuqi, u cilësua si një arritje dhe një progres në drejtim të zhvillimit të konstitucionalizmit hungarez, meqë sanksiononte në mënyrë përmbledhëse krejt të arriturat e këtij vendi pas rënies së komunizmit, amendamentet kushtetuese të vitit 2013 u cilësuan nga Komisioni i Venecias si diçka mjaft e shëmtuar në lëmin e zhvillimit të konstitucionalizmit në këtë vend. Cilat janë tri aspektet e ndryshimit në juridiksionin, përkatësisht në rolin dhe pozitën e **GJKHu**, që këto amendamente të shëmtuara i kanë shkaktuar në gjyqësinë kushtetuese të këtij vendi?

5.4.13. Sipas Kushtetutës së Vogël, **TKPol** kishte mangësi të madhe në juridiksionin e vet. Mangësia në kompetencat e tij vinte si pasojë e natyrës së përkohshme të **Kushtetuës së Vogël**. Draftuesit e saj kishin thënë se ai nuk mund të ishte interpretuese e një dokumenti të përkohshëm, përkatësisht se një kompetencë e tillë e plotë mund t'i jepej vetëm pas nxjerrjes së dokumentit të vërtetë dhe të plotë kushtetues. Kjo ndodhi në vitin 1997 kur u nxor **Kushtetuta e Polonisë**, aktualisht në fuqi. Autorizimet e **TKPol** me këtë hap u zgjeruan dukshëm dhe u bënë të njëjta më gjykatat kushtetuese të vendeve ish-komuniste të Evropës. Cilat ishin kompetencat e reja që i mori ai sipas kësaj kushtetute?

5.4.14. Sipas ndryshimeve kushtetuese të vitit 1968, të cilat mundësonin themelimin e **GJKÇK**, parashikohej edhe themelimi i gjykatave kushtetuese në dy republikat federale, Çekia dhe Sllovakia. Kjo nënkuptonte se gjyqësia kushtetuese Çekosllovake mendohej të kishte fizionomi të njëjtë me gjyqësinë kushtetuese jugosllave. Çfarë do të thotë kjo?

5.4.15. GJKSlk ka kompetencë për të vendosur edhe për kontrollin represiv dhe preventiv të marrëveshjeve ndërkombëtare. Çfarë nënkupton kjo kompetencë?

5.4.16. Sipas Kushtetutës, **GJKÇe** definohet si një trup gjyqësor, i cili është përgjegjës për mbrojtjen e kushtetutshmërisë, kurse kompetencat e saj të përcaktuara në nenin 87 janë shumë të ngjashme me ato të **GJKSlk**. Megjithatë, në mes tyre ekzistojnë tri dallime sa i përket aspektit juridiksional, dy prej të cilave bazohen në tekstin kushtetues, kurse njëri dallim buron nga ndikimi gjerman në gjyqësinë kushtetuese të këtij vendi. Diskutoni!

5.4.17. Gjatë përvojës së saj që nga themelimi, Gjykata Kushtetuese e Çekisë ka provuar në mënyrë të përsëritur që të bëjë transplantimin në sistemin kushtetues çek të doktrinave dhe përvojave gjermane, përfshirë këtu edhe doktrinën mbi **efektin rrezatues** mbi tërë sistemin juridik-kushtetues çek të të drejtave dhe lirive njerëzore. Ky efekt është cilësuar si i ashtuquajturi **efekti i llojit të tretë**, krahas **efektit të drejtpërdrejtë** dhe **efektit horizontal** të të drejtave dhe lirive të njeriut. Çka nënkuptohet me tri këto doktrina?

5.4.18. Një dispozitë jashtëzakonisht e qëlluar dhe specifike e **Kushtetutës së Bullgarisë** të vitit 1991 gjendet në paragrafin e fundit të nenit 149. Në këtë dispozitë qartë përcaktohet se autorizimet dhe detyrat e GJKBu nuk mund të caktohen dhe as të merren me ligj. Kjo nuk është kështu me Kosovën dhe me një pjesë bukur të madhe të vendeve që kanë gjyqësi të ndarë kushtetuese. Çfarë do të thotë kjo dispozitë e bullgarëve dhe cila është rëndësia e saj?

5.4.19. GJKRu deri në reformën kushtetuese të vitit 2003 ka pasur një kompetencë mjaft të ngjashme me **Gjykatën Kushtetuese të Kosovës** dhe që mëton të ruajë supremacinë (epërsinë) e parlamentit, jo të kushtetutës. Për çfarë kompetence bëhet fjalë këtu?

5.4.20. Në vitin 2015, **Federata e Rusisë** ka amendamentuar Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Federatës Ruse të vitit 1994. Më këto amandamente, **GJKFR**, jo **GjEDNJ,** ka për detyrë sigurimin e supremacisë

(epërsisë) se **Kushtetutës së Federatës së Rusisë**. Si bazë (pretekst) për një gjë të tillë ka shërbyer një rast, i njohur si **Anchugov & Glatkov kundër Rusisë** (2013). Me këto hapa, **Rusia** i ka dhënë fund marrëdhënies dialoguese dhe tolerante me rendin evropian të krijuar me KEDNJ dhe të cilin e mbikëqyrë GjEDNJ. Cili është arsyetimi i Rusisë për ndërprerje të kësaj marrëdhënieje dhe në çka konsiston refuzimi rus për të vënë në jetë aktgjykimet e GJEDNJ?

5.4.21. Kushtetuta e Shqipërisë e vitit 1998, aktualisht në fuqi me shumë amendamentime, ka dispozita pak më të ndryshme lidhur me **GJKSH** se ato të përcaktuara më Ligjin 7651. Aktualisht, ajo është e ndarë nga sistemi gjyqësor i rregullt dhe ekzistojnë dispozita të veçanta lidhur me të. Pjesa e tetë ["Gjykata Kushtetuese"] e Kushtetutës i dedikohet vetëm asaj me nenet 124-134. Definohet ndryshe sepse mbrojtja dhe garantimi i ligjshmërisë nuk janë tipare të saj definuese, por vetëm zgjidhja e mosmarrëveshjeve kushtetuese dhe interpretimi përfundimtar i Kushtetutës (neni 124 para.1 i Kushtetutës). Për të realizuar këtë rol të definuar me kushtetutë, kërkohet plotësimi i dy kushteve thelbësore. Cilat janë ato kushte?

5.4.22. Komisioni i Venecias i ka rekomanduar **Ukrainës** që ta fusë në sistemin e vet kushtetues **ankesën e plotë kushtetuese** me qëllim të përafrimit të saj me standardet evropiane më të larta për mbrojtjen efektive të të drejtave dhe lirive kushtetuese. Çfarë do të thotë kjo? Cila është esenca e dallimit në mes të **ankesës së plotë kushtetuese** dhe **ankesës jo të plotë kushtetuese**?

5.5. Lexim shtesë

- Jean – Pierre Massias, *Droit constitutionel des Etats d' Europe de l'Est* (Presses Universitaires de France: Paris, 1999);
- Gustavo Zagrebelsky & Valeria Marceno, *Giustizia costituzionale* (Il Mulino: 2012, Bologna);
- Franchesko Saverio Marini, *Appunti di GIUSTIZIA COSTITUZIONALE* (G. Giappichelli Editore: Torino, 2005);
- Arne Mavcic, *The Constitutional Review*. Second Edition (Vandeplas Publishing, LLC: USA, 2013);
- Lucio Pergorario, *Guistizia costituzionale comparata. Dai modelli ai sistemi* (G. Giappichelli Editore: Torino, 2015).

6. SISTEMET (III): VENDET E AMERIKËS LATINE DHE KARAIBET

Përgjithësisht.- Në origjinën e vet, ani se i takon **sistemit civil** (**kontinental**) të së drejtës, **Amerika Latine** ka qenë nën ndikimin e fuqishëm të Gjykatës Supreme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (GJSSHBA) dhe doktrinës amerikane, sa i përket vijave kryesore të ndërtimit të strukturës shtetërore politiko-institucionale dhe normative. Ndikimi në ndërtimin e strukturës normative në veçanti vërehet nga vitet e para të shekullit XIX, kur futet në përdorim koncepti i kushtetutës së shkruar si një realitet normativ që ngrihet mbi procesin politik, në jetën sociale dhe ekonomike të secilit vend latine-amerikan të kohës, si një ligj suprem, real dhe efektiv, i cili përmban norma të drejtpërdrejta të aplikueshme si ndaj organeve të shtetit ashtu edhe ndaj individëve. Ky koncept i kushtetutës së shkruar, i kuptuar në këtë mënyrë, në **SHBA** u përqafua që nga fundi i shekullit XVIII.

Thuajse në të gjitha vendet latine-amerikane është vërejtur se, në të njëjtën kohë me lindjen e kushtetutave të para të shkruara ka lindur edhe parimi i supremacisë (epërsisë) së kushtetutës së shkruar. Në mbrojtje të këtij parimi mbi supremacinë (epërsinë) e kushtetutës janë krijuar në mënyrë progresive bazat për ndërtim të një sistemi të gjyqësisë kushtetuese të modeluar sipas përvojës së **SHBA**-ve, i njohur si **kontrolli gjyqësor** (**judicial review).** Ky term dhe përmbajtja e tij, megjithatë, kanë kuptim më të gjerë sepse përfshin kontrollin gjyqësor të çdo veprimi të autoritetit publik, në ndërkohë që ne këtu flasim vetëm për kontrollin gjyqësor që ka për qëllim sigurimin e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës.

Në ndjekje të rrugës së revolucioneve amerikane të vitit 1776 dhe franceze të vitit 1789, konstitucionalizmi latine-amerikan fillimisht ka rrëshqitur në kulturën jakobine, përkatësisht në vazhdimin e njohjes së supremacisë (epërsisë) absolute të pushtetit legjislativ si një organ sovran me fjalën e fundit. Për këtë arsye, kontrolli i kushtetutshmërisë në këtë fazë fillestare nuk ka mundur të jetë pos politik sepse nuk mund të imagjinohej themelimi i një organi tjetër për kontroll kushtetues jashtë trupit të njëjtë legjislativ. Ky cilësohet, siç e kemi theksuar në kapitujt e mëhershëm, si **Senati Konservator**, sipas përvojës franceze menjëherë pas vitit 1789. Në këtë mënyrë, **kontrolli politik** ka qenë lloji i parë i kontrollit i transplantuar në këtë kontinent në fillimin e pavarësisë së tij nga kolonializmi evropian (në rend të parë spanjoll, por edhe portugez, francez dhe britanik). Ky transplantim është ndikuar nga rrënjët e traditës evropiane/kontinentale të sistemit juridik të vendeve latine-amerikane. Këtë kontroll politik fillimisht e gjejmë në **Peru**[1] me Kushtetutën e vitit

[1] Kongresi njëdhomësh, sipas nenit 51 të kapitullit 3 ["Pushteti Legjislativ"] të **Kushtetutës së Perus** ishte autoriteti ligjvënës në vend Në nenin 60 janë listuar autorizimet e kongresit. Nën pikën e parë të paragrafit të parë listohet autorizimi i Kongresit për nxjerrjen, interpretim, ndryshimin dhe anulimin e çdo ligji. Në dispozitat e neneve 186-188 ["Respektimi i Kushtetutës"] të Kushtetutës flitet më konkretisht për modalitetet e kontrollit politik të kushtetutshmërisë në këtë vend dhe në këtë kohë. Në nenin 186 Kongresit i jepej autorizimi për të rishikuar cenimet e Kushtetutës të kryera nga legjislacioni i miratuar, të cilat cenime duheshin evituar menjëherë. Neni në vijim, neni 187, i jepte të drejtën çdo individi në Peru për të iniciuar para Kongresit apo para Ekzekutivit çdo cenim të Kushtetutës. Së fundi, neni 188 i detyronte të gjithë funksionarët publik peruan për të respektuar Kushtetutën dhe për të qenë lojal ndaj dispozitave të saj. Cf. *Constitutcion Politica de la Republica Peruana (1823)*. Në internet : http://www.modern-constitutions.de/nbu.php?page_ id= 02a1b5a86ff139471c0b1c57f23ac196&shoë_doc=PE-00-1823-11-12-es&vieëmode=image_metadata (shikuar në korrik 2017).

1823, **Brazil**[2] me Kushtetutën e vitit 1824, në **Bolivi**[3] më Kushtetutën e këtij vendi të vitit 1826, në **Kil**[4] me Kushtetutën e vitit 1833 dhe, së fundi, në **Ekuador**[5] me Kushtetutën e vitit 1851.

Gjykimi i kushtetutshmërisë përmes rrugës gjyqësore, sipas modelit të **SHBA**-ve, në këtë kontinent ka nisur vetëm në gjysmën e dytë të shekullit 19-të. Si moment kyç i kthesës nga sistemi politik i kontrollit kushtetues në kontrollin kushtetues juridiksional që ushtrohet nga një mekanizëm gjyqësor merret viti 1841, kur është nxjerrë **Kushtetuta e Shtetit Jukatan të Meksikos**. Ky moment dëshmon se sistemi difuz (i decentralizuar) i kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve tjera juridike është i pajtueshëm me të gjitha sistemet juridike, si atij të së **drejtës së përgjithshme** (**common law**) ashtu dhe të atij të së **drejtës civile** (**kontinentale**), në të cilin bëjnë pjesë vendet e Amerikës Latine. Mirëpo, duke theksuar se përqafimi nga këto vende i modelit të SHBA-ve asnjëherë nuk ka nënkuptuar riprodhim të verbër të cilësive dhe modaliteteve të funksionimit të tij. Kjo vërehet më zhvillimet e mëpastajshme të gjyqësisë kushtetuese në këtë kontinent, pra pas vitit 1841, kur u zhvilluan **modeli i kontrollit kushtetues difuz** (**i decentralizuar**) sipas traditës amerikane, dhe **modeli i koncentruar** (**i centralizuar**) sipas **traditës civile** (**kontinentale**). Ajo çfarë ka qenë e papajtueshme me sistemin e **të drejtës së përgjithshme** (**common law**) ka të bëjë me natyrën juridike dhe efektin e vendimeve të gjykatave në çështjet kushtetuese. Kjo do të shihet në vijim, kur të flasim për doktrinën ***stare decisis***, si diçka që ka lindur si rezultat i evoluimit nga nevoja të sistemit të së **drejtës së përgjithshme** (**common law**), dhe dallimin e saj me natyrën juridike dhe efektet **inetr partes** apo **erga omnes** të vendimeve të gjyqësorit në çështjet kushtetuese në **sistemin civil** (**kontinental**), diçka që qartë përcaktohet me kushtetutën nacionale të secilit vend.

Ky i fundit, me kalimin e kohës, akoma më shumë ka fituar në lëmin e gjyqësisë kushtetuese trajta të ndryshme të manifestimit të dallueshëm nga sistemi amerikan i të drejtës së përgjithshme (**common law**). Ndër këto trajta më e rëndësishmja është fakti se u krijua një model latino-amerikan i

---

2 Neni 15 nën IX i kapitullit I ["Pushteti Legjislativ dhe Kompetencat"] **i Kushtetutës së vitit 1824 i përcakton si një ndër kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme edhe "[...] kujdesin për ruajtjen e Kushtetutës dhe promovimin e mirëqenies së kombit", kurse në paragrafin paraprak nën VIII të nenit të njëjtë asaj i njihet edhe kompetenca për të nxjerrë dhe interpretuar ligjet që i nxjerr. Cf. *República Federativa de Brasil/ Federative Republic of Brazil*** Constitución Política de 1824 1824 Constitution. Në internet: http://pdba.georgetoën.edu/ Constitutions/Brazil/brazil1824.html#mozTocId856414 (shikuar në korrik 2017).

3 Sipas nenit 26.1 [Titulli 4, Kapitulli I: "Mbi Pushtetin Legjislativ"] të **Kushtetutës së Bolivisë** të vitit 1826, pushteti legjislativ përbëhej prej tri dhomave: 1. **Dhoma e Tribunëve**; 2. **Dhoma e Senatorëve**; dhe 3. **Dhoma e Censorëve**. Tri janë momentet në tekstin e kësaj kushtetuete që flasin për kontrollin politik të kushtetutshmërisë: momenti i parë është në nenin 46.4 që autorizion, inter alia, **Senatin** për iniciativën ligjore me qëllim të korrigjimit të shkeljeve kushtetuese. I dyti moment shfaqet në pikën e parë të nenit 50 që flet për autorizimet e **Dhomës së Censorëve** si një autorizim ligjor të kësaj dhome për të shikuar nëse Qeveria po zbaton Kushtetutën si dhe nëse Kushtetuta, ligjet dhe traktatet publike po zbatohen nga pushteti ekzekutiv. Së fundi, momenti i tretë vjen menjëherë në pikën e dytë të nenit të njejët, nenit 50 të Kushtetutës, që i jep kësaj dhome të drejtën për të ngritur akuzat para **Senatit** për shkeljet e Kushtetutës, të ligjeve dhe traktateve publike të kryera nga ekzekutivi. Cf. *Proyecto de Constitucion para la República Boliviana (1826)*. Në internet: http://www.modern-constitutions. de/nbu.php?page_ id=02a1b5a86ff13947 1c0b1c57f23ac1 96&shoë_doc =BO-00-1826-05-25-es&viewmode=edition_metadata (shikuar në korrik 2017).

4 **Kushtetuta e Kilit** e vitit 1933, në fuqi deri më 1925, poashtu bën pjesë në kushteutat latino-amerikane që kanë sanksionuar kontrollin politik të kushtetutshmërisë. Ky kontroll përqëndrohej në duart e Kongresit, i cili përbëhej nga dy dhoma – Dhomën e Deputetëve dhe Senatin. Në nenin 155 ["Zbatimi dhe Amendamentimi i Kushtetutës"] të Kushtetutës thuhej se vetëm Kongresi kishte të drejtën e vendosjes lidhur me çdo dyshim që mund të lindtte sa i përket interpretimit të secilit prej neneve të Kushtetutës. Cf. *Political constitution of the Republic of Chile: promulgated May 25, 1833, with the amendments doën to May 1, 1899.* Në internet: https://archive.org/stream/politicalconsti00tookgoog/politicalconsti00tookgoog_djvu.txt (shikuar në qershor 2017).

5 Në nenin 136 ["Mbi Interpretimin dhe Reformën e Kushtetutës"] të **Kushtetutës së Ekvadorit** të vitit 1851 flet për autorizimin ekskluziv të Asamblesë Kombëtare, organit legjsilativ njëdhomësh, për interpretim të Kushtetutës dhe për vendosjen lidhur me çdo kundërthënie të dispozitave kushtetuese ndërmjet veti. Përveç kësaj, pranë këtij organi çdo qytetar mund të parashtroj kërkesën për cenim të Kushtetutës. Kërkesa e tillë mund të paraqitet edhe pranë Qeverisë. Pra, sipas kësaj Kushtetute, këto dy organe kanë pasur kompetencë ekskluzive për të vendosur lidhur me çdo cenim të Kushtetutës të iniciuar nga qytetarët e këtij vendi. Cf. *Constitución de 1851 (25 de febrero de 1851)*. Në internet: http://www. constitutionnet. org/sites/ default /files/ 1851. pdf (shikuar në korrik 2017).

veçantë në të cilin gjyqësia kushtetuese ushtrohet nga autoriteti i fundit gjyqësor në vend (gjykata supreme, gjykata e lartë, gjykata e lartë e drejtësisë etj.) apo nga një gjykatë kushtetuese, e ndarë nga gjyqësori i rregullt në hierarkinë vertikale dhe me juridiksion të specializuar të përcaktuar me kushtetutë apo ligje tjera (ani se mund të ndodhë që formalisht edhe gjykata kushtetuese të jetë pjesë e gjyqësorit, mirëpo kjo nuk ndryshon asgjë).[6] Në kuadër të këtyre trajtave të manifestimit, kontrollin abstrakt e kanë të përcaktuar me kushtetutë nacionale një numër bukur i madh i vendeve latine - amerikane. Ky juridiksion i bën këto vende të dallueshme nga gjyqësia kushtetuese e SHBA-ve, ku asnjëherë asnjë gjykatë nuk mund të ushtrojë kontroll abstrakt të ligjeve dhe akteve tjera juridike. Në fakt, **Amerika Latine** cilësohet si një hibridizim në kuptimin që shumica e vendeve përmes tekstit kushtetues i kanë ruajtur cilësitë juridiksionale të dy sistemeve (kontrollin abstrakt dhe konkret të kushtetutshmërisë). Lindja e këtij sistemi të **përzier** (mikst), historikisht shikuar, ka ndodhur fillimisht si rezultat i evoluimit. Kjo sepse kushtetutat e para të këtyre vendeve nuk kanë përmbajtur dispozita mbi kontrollin gjyqësor të kushtetutshmërisë, duke mos u njohur gjykatave asnjë rol formal të arbitrit në ushtrimin e pushtetit politik nga ana e degëve tjera të pushtetit.

Ka disa arsye që shpjegojnë dobësinë e institucioneve gjyqësore në këto vende në të kaluarën. Disa flasin për kolonializmin si shkak, kurse tjerët për efektin **inter partes** të vendimeve të gjyqësorit deri kur u bë zëvendësimi i tyre me efektet **erga omnes**, kurse shumë autorë flasin për mungesën e demokracisë në këto vende si shkak primar i dobësisë së gjyqësorit latino-ameikna. Ky argument i fundit ka prevaluar sepse vërtetë vetëm në një ambient demokratik me një fragmentim të pushtetit politik mund të ketë gjyqësor të pavarur, vendimet e të cilit në çështjet e përgjithshme dhe në ato me karakter kushtetues kanë efekte **erga omnes** në rastet që kanë të bëjnë me sigurimin e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës. Kjo në **Amerikën Latine** ka ndodhur vetëm kah mesi i viteve 1980 kur nisi vala e demokratizimit të kontinentit[7]. T'i kthehemi sërish çështjeve të efekteve **inter partes** të cilat i kanë pasur gjykatat latine-amerikane në çështjet kushtetuese për shumicën e kohës së ekzistimit të tyre e deri në nisjen e valës së demokratizimit në këtë kontinent.

Një aspekt tjetër që i bën të dallueshme këto vende nga **SHBA**-të ka të bëjë me efektin dhe natyrën e vendimeve të gjykatave vendore lidhur me çështjet kushtetuese: në sistemin amerikan, vendimet e **GJSSHBA** në çështjet kushtetuese kanë natyrë juridike **stare decisis**. Kjo nënkupton se gjykatat tjera të nivelit më të ulët duhet t'i nënshtrohen sikur ligjit dhe kushtetutës nacionale autoritetit të vendimit të dhënë nga gjykata supreme apo gjykata tjetër më e lartë në vend lidhur me një çështje konkrete kushtetuese. Ky efekt, i njohur si efekti i doktrinës **stare decisis**, sipas të cilit vendimet e organit më të lartë në vend lidhur me çështjet kushtetuese obligojnë të gjitha gjykatat tjera më të ulëta në vend për ta ndjekur precedentin e dhënë në një rast apo mosmarrëveshje konkrete, njëjtë siç obligon kushtetuta dhe ligji. Kjo është në natyrën e vendeve të sistemit të së drejtës së përgjithshme (common law), kurse i huaj deri vonë për **sistemin civil të së drejtës** (**sistemi kontinental**). Në këtë sistem nuk ka **stare decisis**, por efekti i njëjtë arrihet përmes efektit **erga omnes** të vendimeve në çështjet kushtetuese. Kjo përcaktohet qartë me kushtetutë nacionale, e cila saktëson formën dhe caqet e fuqisë detyruese të vendimeve të dhëna në çështjet kushtetuese ndaj të gjithëve.

Doktrina **stare decisis,** ndërkaq, ka të bëjë me natyrën juridike të vendimit për të ardhmen, do të thotë se vendimi i dhënë në një rast konkret apo mosmarrëveshje vlen në mënyrë të njëjtë sikur kushtetuta apo ligji dhe obligon të gjitha gjykatat tjera për ta vënë në jetë në mënyrë të njëjtë si kushtetutën dhe ligjin me rastin e zgjidhjes apo vendosjes së rasteve apo mosmarrëveshjeve konkrete. Si e tillë, doktrina **stare decisis** lidhet me evoluimin e sistemit të së drejtës së përgjithshme (**common law**) dhe nuk ka qenë rezultat i përcaktimeve të tekstit të shkruar kushtetues. Për pasojë, doktrina e tillë është e huaj për sistemin civil (**kontinental**)

---

6 Përveç **Kilit** dhe **Perus**, në fakt, të gjitha vendet tjera gjyqësinë kushtetuese ia kanë besuar gjykatave, të cilat operojnë në kuadër të sistemit të rregullt gjyqësor, ani se në disa raste këto gjykata janë gjykata kushtetuese me juridiksion të specializuar në lëminë kushtetues, i cili ushtrohet po ashtu nga një institucioni i ndarë i emërtuar si gjykatë nacionale kushtetuese. Cf. Patricio Navia **&** Julio Rios - Figueroa, "The Constitutional Adjudication Mosaic of Latin America." *Comparative Political Studies* Vol. 38 Issue 2 (2005) fq. 189-217 në fq. 191-192.

7 Ibid. fq. 193-196.

të së drejtës, në të cilin teksti kushtetues qartë përcakton nëse vendimet gjyqësore në çështjet kushtetuese do të kenë efekt **inter partes**, **erga omnes** apo të dyja së bashku, në varësi të natyrës së vendimit dhe mënyrës se si është marrë. Kjo aspak nuk lidhet me atë nëse një vend ka apo nuk ka një gjykatë të ndarë kushtetuese: me rëndësi është nëse organi që vendos ka juridiksion të qartë dhe të ndarë në çështjet kushtetuese. Një gjë e tillë me së miri vërehet me vendet e **Amerikës Latine** dhe zgjidhjet kushtetuese të përqafuara atje, të cilat diskutohen në këtë kapitull. Pas demokratizimit të tyre të filluar në mesin e viteve '80 të shekullit të kaluar, kushtetutat e tyre qartë i zëvendësuan dispozitat mbi efektet **inter partes** të vendimeve gjyqësore në çështjet kushtetuese me dispozita të qarta mbi efektin **erga omnes** të vendimeve në fjalë. Kjo bëri të mundur që të krijohet kontrolli gjyqësor i kushtetutshmërisë në kuptimin real të kësaj fjale dhe të krejt asaj që ai koncept përfaqëson në konstitucionalzimin bashkëkohor perëndimor.[8]

Në këtë kontekst, në vijim si më sipër, këto vende, **grosso modo**, në literaturë grupohen ne tri grupe. Në grupin e parë bëjnë pjesë **Bolivia, Kosta Rika, Guatemale, Meksiko** dhe **Venezuela**. Në këto vende, është në tërësi e detyrueshme për nga natyra juridike praktika gjyqësore (jurisprudenca) e gjykatave (më të larta në vend) lidhur me çështjet kushtetuese të vendosura nga ana e gjykatës më të lartë. Në grupin e dytë bëjnë pjesë **Argjentina, Brazili, Kolumbia, El Salvador** dhe **Peru.** Në këto vende, natyra juridike praktika gjyqësore (jurisprudenca) e gjykatave (më të larta në vend) lidhur me çështjet kushtetuese të vendosura nga ana e gjykatës më të lartë ndiqet, por nuk është e detyrueshme me kushtetutë dhe ligj për t'u ndjekur dhe respketuar. Në grupin e tretë dhe të fundit bëjnë pjesë **Kili, Ekvadori, Hondurasi, Nikaragua, Panama, Paragvaj, Republika Dominikane**, dhe **Urugvaji**. Në këto vende, natyra juridike praktika gjyqësore (jurisprudenca) e gjykatave (më të larta në vend) lidhur me çështjet kushtetuese të vendosura nga ana e gjykatës më të lartë shërben për gjykatat më të ulëta vetëm si një orientim dhe asgjë më shumë.[9] Disa nga këto vende, siç do të shihet në fillim, kanë sistem të koncentruar me gjykatë kushtetuese, disa të koncentruar pa gjykatë kushtetuese, kurse disa tjera sistem difuz të modeluar sipas sistemit amerikan.

Në kuadër të modelit të fundit të kontrollit kushtetues si më sipër, siç do të shihet, në këtë kontinent u krijuan praktika në të cilat akoma u ruajtën në vetvete traditat e kontrollit **difuz** (të decentralizuar) krahas atij të **koncentruar** (të centralizuar). Fjalën e fundit në çështjet kushtetuese, megjithatë, sërish e ka organi më i lartë në vend i veshur me autorizim për të ruajtur dhe siguruar supremacinë (epërsinë) e kushtetutës në krahasim me çdo ligj, akt apo veprim tjetër juridik. Në këtë rast fare nuk çon peshë nëse ky organ funksionon në vijë vertikale si hallkë e fundit e sistemit të rregullt gjyqësor apo ushtrohet nga ana e një gjykate kushtetuese, e cila mund të jetë e ndarë në vijë vertikale nga sistemi i rregullt gjyqësor por edhe mund të jetë pjesë e këtij sistemi gjyqësor, duke qenë hallkë e fundit e tij në çështjet kushtetuese. Ky model, siç u tha cilësohet ndryshe edhe si **modeli i përzier** (mikst) i kontrollit kushtetues, sepse krahas ekzistimit të kontrollit kushtetues të koncentruar (centralizuar) apo abstrakt ekziston edhe kontrolli kushtetues difuz (i decentralizuar) apo konkret në të cilin gjyqtari apo gjyqtarët e rastit kanë të drejtë për të mos e zbatuar ligjin, normën apo aktin tjetër juridik në rastin konkret që pret zgjidhje pranë tij/tyre[10]. Në **modelin e përzier** (miks), megjithatë, lidhur me çështjet kushtetuese në fund sërish fjalën e fundit mund ta ketë një organ

---

8 Ibid. fq. 193.

9 Miguel-Stearns, Teresa M., "Judicial Power in Latin America: a Short Survey" (2015). *Librarian Scholarship Series.* Paper 32. fq. 100-107 në fq. 101. Në internet: http://digitalcommons.law.yale.edu/ylss/32 (shikuar në qershor 2017).

10 Në vendet e Amerikës Latine me **model të përzier** (mikst) hyjnë: **Bolivia, Nikaragva, Kolumbia, Guatemala, Ekuadori, Peru, Meksiko**, dhe **Venezuela**. Mirëpo, ne këtu bëjmë ndarjen në katër grupe te vendeve: i pari gurp është ku nuk ka fare sistem të kontrollit kushtetues por ku të gjitha gjykatat janë të autorizuara të bëjnë kontrollin kushtetues. Ky njihet si sistemi difuz (i decentralizuar), i cili modelohet sipas sistemit amerikan. Pak vende kanë një sistem amerikan të pastër në Amerikën Latine. Në grupin e dytë hyjnë vendet që kanë sistem të koncentruar (të centralizuar) të kontrollit kushtetues. Ky koncentrim mund të jetë në një gjykatë të ndarë kushtetuese apo në një gjykatë të rregullt, e cila gjendet në krye të gjyqësorit të rregullt. Si në rastin e parë ashtu dhe në të dytin, vendet e ndryshme mund të përfaqësojnë, krahas sistemit të tillë të koncentruar (centralizuar) edhe sistemin difuz (të decentralizuar), kur në një gjykim incidental kryhet edhe kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjit, normës apo aktit juridik që duhet të zbatohet në rastin konkret. Kur ky është rasti, këto vende cilësohen si sisteme mikste (të përziera) të kontrollit kushtetues. Në grupin e fundit kemi futur vendet tjera që kryesisht janë ish kolonitë e vendeve të ndryshme evropiane që kanë ndikuar në kulturën dhe sistemet juridike të disa prej vendeve të **Amerikës Latine** dhe që për këtë arsye i ndajmë në një grup të veçantë.

i veshur me juridiksion të qartë të përcaktuar me kushtetutë. Ky organ cilësohet si "gjykatë supreme", "gjykatë supreme e drejtësisë", "dhomë kushtetuese e posaçme e gjykatës supreme të drejtësisë" gjykatë kushtetuese", "tribunal kushtetues", etj. etj. Emërtimi nuk çon peshë fare sepse përcaktuesi kryesor që e dallon sistemin difuz (të decentralizuar) prej atij të koncentruar (centralizuar) është se në rastin e parë secili gjyqtar vendos në mënyrë autoritative lidhur me një çështje kushtetuese në një rast apo mosmarrëveshje konkrete, duke mos zbatuar ligjin apo normën konkrete në atë rast apo mosmarrëveshje konkrete, kurse, në rastin e dytë, vetëm një gjykatë në nivel nacional ka juridiksion për të vendosur në çështjet kushtetuese, gjë e cila përcaktohet qartë me kushtetutë nacionale.[11] Në rastin kur në një vend lejohet që të ketë edhe kontroll kushtetues konkret nga të gjithë gjyqtarët e të gjitha gjykatave vendore por që në fund fjalën e fundit e jep instanca më e lartë në vend në çështjet kushtetuese sepse një gjë e tillë përcaktohet qartë me kushtetutë dhe me ligje organike apo me ligje kushtetuese në nivel vendi, atëherë ky quhet model apo sistem i përzier.

Në modelin e pastër difuz (**decentralizuar**) asnjëherë nuk mund të ushtrohet kontrolli abstrakt i kushtetutshmërisë, siç është rasti me **SHBA**. Në sistemin e koncentruar (**centralizuar**) apo në atë të përzier (**mikst**), një gjë e tillë nuk përjashtohet. Kjo, megjithatë, nuk është ndarja e seksioneve që kemi ndjekur në këtë kapitull, por përcaktimet kushtetuese të vendeve të **Amerikës Latine** dhe vetë dizajnin e tyre institucional të përcaktuar me kushtetutat nacionale. Me fjalë të tjera, përcaktimet kushtetuese dhe dizajni institucional i organizimit të pushtetit kanë qenë faktorë kyç në ndarjen e seksioneve të këtij kapitulli. Mbi bazën e këtyre dy kritereve, të gjitha vendet i kemi ndarë në tri grupe: në grupin e parë janë vendet që kanë pasur (apo kanë akoma) model difuz (**decentralizuar**) të kontrollit gjyqësor. Në grupin e dytë kemi futur vendet me sistem të koncentruar (**centralizuar**), por pa gjykatë kushtetuese. Në vendin e tretë dhe të fundit, natyrshëm kemi grumbulluar vendet që kanë sistem të koncentruar (**centralizuar**), por me gjykatë kushtetuese (e cila në anën tjetër mund të jetë brenda gjyqësorit si hallkë e fundit në sistemin vertikal të organizimit gjyqësor, apo e ndarë prej tij në vijë vertikale të organizimit të gjyqësorit në nivel nacional).

Në disa raste flasim edhe për aspektet historike të përqafimit të një modeli në një vend ashtu që mund të duket se vendet e njëjta janë në të njëjtën kohë të përfaqësuara në tri modelet e gjyqësisë kushtetuese latine-amerikane. Ky, megjithatë, nuk është rasti. Kjo nuk është kështu sepse ne i referohemi, në disa raste, historikut të zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese në një vend për të dalë te gjendja aktuale sot. Këtë e bëjmë sepse në **Amerikën Latine** ekzistojnë shumë dallime në modalitetet e zgjidhjeve normative dhe sa i takon vetë funksionimit të gjyqësisë kushtetuese. Në të njëjtën kohë, megjithatë, ekzistojnë shumë ngjashmëri ndërmjet vendeve sa i përket parametrave të njëjtë (zgjidhja normative dhe vetë mënyra e funksionimit të mekanizmave institucional që ushtrojnë gjyqësinë kushtetuese). Nga e kaluara e këtyre vendeve, qartë shihet se kanë eksperimentuar me shumë zgjidhje kushtetuese dhe institucionale sa i përket modeleve të gjyqësisë kushtetuese, gjithnjë me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së kushtetutës dhe rendit të bazuar në të. Këtë e kanë bërë duke transplantuar praktika dhe zgjidhje nga traditat e jashtme dhe duke krijuar procedura e instrumente specifike, siç është rasti me institutin **amparo**, mirëpo gjithnjë duke i ndenjur besnik traditës juridike të **sistemit civil** (**kontinental**). Këtë lexuesi ynë duhet çdoherë ta ketë parasysh përgjatë leximit të këtij teksti.

---

[11] Nga kjo del se është gabim mendimi sipas të cilit efektet **inter partes** dhe **erga omnes** të vendimeve barazohen me pasjen ose jo të një gjykate të ndarë kushtetuese e cila funksionon jashtë sistemit të rregullt gjyqësor. Sipas këtij mendimi gjykata kushtetuese, historikisht dhe aktualisht, sipas fizionomisë së saj jep vendime me efekt **erga omnes**, vendime të cilat kanë natyrë juridike me fuqi **stare decisis** në sistemin gjyqësor në SHBA, në ndërkohë që gjykatat e rregullta më të larta në nivel nacional të cilat ushtrojnë juridiksion në çështje kushtetuese nxjerrin vetëm vendime me efekt **inter partes**, pa pasur natyrë juridike të një **stare decisis** në kuptimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme në SHBA. Kjo, megjithatë, nuk është kështu. Cf. për mendim të kundërt në Patricio Navia **&** Julio Rios - Figueroa, "The Constitutional Adjudication Mosaic of Latin America.", fq. 197-198, ku jepen autorët me pikëpamje të tilla dhe arsyet e tyre për to.
Ajo çka ka rëndësi dhe që çon peshë, është se në vendet e **Amerikës Latin**e, me ndryshimet demokratike janë nxjerrë kushtetuta të reja, pas mesit të viteve '80 të shekullit të kaluar, të cilat qartë përcaktojnë juridiksionin kushtetues, difuz apo të centralizuar, zakonisht në favor të gjykatës më të lartë në vend, si dhe natyrën juridike të pastër **stare decisis** të vendimeve të dhëna në çështjet kushtetuese. Në disa raste, efekti **erga omnes**, natyra e detyrueshme e vendimeve të gjyqësorit të rregullt në çështje kushtetuese kushtëzohet me mënyrën e votimit: për të qenë të tilla, zakonisht kërkohet një shumicë e kualifikuar e gjyqtarëve (ta zëmë, **Argjentina**, **Brazili, Meksika** etj., ku gjykatat më të larta në vend për të siguruar efektet **erga omnes** të vendimeve të tyre në çështjet kushtetuese duhet t'i nxjerrin ato vendime me një shumicë të kualifikuar të gjyqtarëve).

Fare në fund, shënojmë se këtu nuk diskutojmë gjendjen në njëzet vendet sovrane dhe të pavarura të **Amerikës Latine**, por vetëm në ato më të veçantat, të cilat shërbejnë si një pasqyrë e përgjithshme e gjendjes së gjyqësisë kushtetuese në këtë kontinent.

6.1. Modeli difuz (i decentralizuar) i ndikuar nga SHBA-të

Përqafimi i modelit të kontrollit difuz (**decentralizuar**) të gjyqësisë kushtetuese nënkupton se secili gjyqtar, pavarësisht nga shkalla e gjyqësorit ku vepron, mund të ushtrojë vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve tjera normative. Në këtë model është detyrim i çdo gjyqtari për të gjykuar mbi pajtueshmërinë me kushtetutën të secilit ligj apo akt juridik tjetër normativ, i cili duhet të zbatohet me rastin e zgjidhjes apo vendosjes së një rasti apo mosmarrëveshjeje konkrete. Në rastin kur **iudex a quo** (gjyqtari i rastit) gjen se ligji apo akti tjetër normativ nuk është në pajtim me kushtetutën, atëherë ai nuk i zbaton ato në rastin apo mosmarrëveshjen konkrete që gjendet para tij. Kjo është cilësia bazike e cila e dallon këtë model nga tjerët. Cilësitë tjera diskutohen në vijim, pasi të japim një pasqyrë të shkurtër të dispozitave kushtetuese të disave vendeve më karakteristike, të cilat për shkak të formulimit të tyre shërbejnë si shenjë dalluese bazike e këtij sistemi me të tjerët.

Në mesin e vendeve të këtij kontinenti që i pari ka përqafuar **modelin difuz** (të decentralizuar) është **Argjentina**. Ky vend ka pranuar sistemin amerikan, jo përmes Kushtetutës së vitit 1853 por përmes një ligji të zakonshëm, **Ligjit nr. 27 /1862 mbi Organizimin e Gjyqësisë Nacionale.** Ky ligj afirmonte në nenin 3 qëllimin parësor të organeve gjyqësore në të gjitha nivelet për të siguruar respektimin e Kushtetutës në tërë territorin argjentinas. Ky qëllim i ligjit, megjithatë, nuk saktësonte se si duhej realizuar ky qëllim dhe në cilin moment të procesit gjyqësor. Vetëm më vonë, në praktikën gjyqësore të këtij vendi, në rastin e njohur si **Sojo** të vitit 1887, **Gjykata Supreme e Drejtësisë në Vend (GJSDA),** si gjykatë më e lartë në vend, përcaktoi një standard të nivelit **Marbury vs. Madison,** kur i njohu të drejtën por edhe detyrën e çdo **iudex a quo** (gjyqtar i rastit) për të vlerësuar kushtetutshmërinë e ligjit apo të aktit tjetër normativ të cilin duhet ta zbatoj me rastin e vendosjes për një rast apo mosmarrëveshje konkrete.[12]

GJSDA u krijua me **Kushtetutën e Argjentinës** të vitit 1853 dhe modelohet sipas GJSSHBA. Kushtetuta e vitit 1853 është ende në fuqi me disa amendamente të mëvonshme të kryera përgjatë shekujve, të cilat për herë të parë kanë filluar më 1860, kurse për herë të fundit më 1994.[13]

Në nenin 108 ["Pushteti Gjyqësor"] të Kushtetutës së vitit 1853, është përcaktuar se "[...] pushteti gjyqësor në vend ushtrohet nga Gjykata Supreme dhe nga gjykata tjera më të ulëta të cilat mund të themelohen nga Kongresi". Sikundër vërehet ka një ngjashmëri me Kushtetutën e SHBA-ve të vitit 1776. Jo vetëm kaq! Në literaturë është vërejtur se vendimet e **GJSSHBA** dhe trajtimet shkencore të këtij vendi kanë ndikuar dukshëm në **Argjentinë**, në veçanti përgjatë shekullit XIX[14], por edhe aktualisht. Kjo nënkupton se kontrolli gjyqësor i kushtetutshmërisë është i ngjashëm më atë që kryhet në SHBA nga Gjykata Supreme dhe, për pasojë, **GJSDA** nuk mund të ushtrojë kontroll abstrakt të normave juridike, por vetëm në kuadër të vendosjes për një rast apo mosmarrëveshje.

Në **Venezuela**, norma e parë që ka vënë në jetë **kontrollin kushtetues difuz** (të përzier), ka qenë neni 20 i **Kodit të Procedurës Civile** i vitit 1897. Ky nen përcaktonte se në rastet kur ligji që duhej zbatuar binte ndesh me një dispozitë kushtetuese, preferohej që gjyqtarët ta zbatonin këtë të fundit.[15] Qasja e kësaj norme

---

[12] Roberta Bille, "La giustizia costituzionale in America latina". Në Luca Mezzetti (ed.), *SISTEMI E MODELLI DI GIUSTIZIA COSTITUZIONALE* (CEDAM: Padova, 2009) fq. 481-566, në fq. 484.

[13] *Constitution of Argentina of 1853, Reinstated in 1983, with Amendments through 1994*. Në internet: https://www.constituteproject.org/constitution/Argentina_1994.pdf?lang=en (shikuar në maj 2017).

[14] Shih më shumë në Christopher J. Walker, "Toward Democratic Consolidation? The Argentine Supreme Court, Judicial Independence, and the Rule of Law". *Florida Journal of International Law* Vol. 18 No. 3, (2010) fq. 745-806.

[15] Sipas Allan Breëer – Carias, *Constitutional protectiuon of Human Rights in Latin America. A Comparative Study of Amparo Proceedings* (Cambridge University Press: Cambridge, 2009) fq. 85 fusnota nr. 145.

është përqafuar sërish në **Kushtetutën e Venezuelës** të vitit 1999, e cila aktualisht është në fuqi[16]. Megjithatë, kjo nuk e bën këtë vend një vend me sistem të decentralizuar: sipas Kushtetutës së vitit 1999, siç do të shihet në vijim, një dhomë e posaçme kushtetuese brenda **Tribunalit Suprem të Drejtësisë** (**TSDV**) ka juridiksion të qartë dhe ekskluziv për çështjet kushtetuese në nivel vendi.

Dekada më vonë, në **Kolumbi**, me fillim nga viti 1910, parashikohej se Kushtetuta është normë mbi normat ashtu që në rast të mospajtimit në mes të saj dhe një ligji apo një norme tjetër juridike, në mënyrë të drejtpërdrejtë duheshin zbatuar dispozitat kushtetuese. Një zgjidhje e njëjtë kushtetuese ekziston në Kushtetutën e Kolumbisë të vitit 1991, aktualisht në fuqi[17].

Në **Guatemalë**, me fillim që nga vitit 1965, u parashikua në tekstin kushtetues parimi i supremacisë (epërsisë) kushtetuese. Sigurimi i kësaj supremacie (epërsie) ishte prerogativë e pushtetit gjyqësor. Ky parim u përsërit në Kushtetutën e vitit 1985, aktualisht në fuqi, e cila në nenin 204 ["Kushtet Thelbësore për Administrimin e Drejtësisë"] përcakton se gjykatat e vendit "[...] në mënyrë të detyrueshme respektojnë parimin sipas të cilit Kushtetuta e Republikës mbizotëron kundrejt çdo ligji apo traktati".[18]

Në **Kushtetutën e El Salvadorit** të vitit 1983, në nenin 185 përcaktohet prerogativë e gjyqtarëve për të mos zbatuar ligjet që cilësohen si jo kushtetuese gjatë procedurave gjyqësore të zgjidhjes së rasteve apo mosmarrëveshjeve konkrete.[19] Në fund fare, **Kushtetutën e Hondurasit** të një viti më herët, 1982, me një formulim tjetër përcillet mesazhi i njëjtët për gjykatat dhe organet tjera, të cilat, sipas redaktimit të nenit 320 të Kushtetutës, "nuk duhet të zbatojnë normat e një ligji të zakonshëm kur bie ndesh me një normë kushtetuese".[20]

E shprehur në një mënyrë më të ndryshme, qasja e njëjtë ekziston edhe në Kushtetutën e **Nikaraguas** të vitit 1987, aktualisht në fuqi, e cila në nenin 166.1 ["Pushteti Gjyqësor"] përcakton "[...] se në ushtrimin e pushtetit gjyqësor, gjyqtarët janë të pavarur dhe i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjit [...][21]". Mirëpo, vetëm me ligj në mënyrë më të saktë është reflektuar modeli difuz (i decentralizuar) i përqafuar në këtë vend. Neni 5 i **Ligjit Organik nr. 260 mbi Pushtetin Gjyqësor në Nikaragua i vitit 1988 (Ligji Organik nr. 206)** stipulon detyrimin e gjyqtarit të rastit **(iudex a quo)** për të mos e zbatuar një ligj apo akt tjetër juridik në një rast konkret që pret zgjidhje pranë tij e që nuk është në përputhje me Kushtetutën. Ky detyrim i gjyqtarit të rastit nis që nga momenti kur ai/ajo vëren se ligji, i cili duhet të zbatohet në një

---

16 Në nenin Neni 334 të Kapitullit I, Titulli VIII ["Mbrojtja e Kushtetutës"] të Kushtetutës së Venezuelës përcaktohet si vijon :
"Të gjithë gjyqtarët e Republikës, në kuadër të kompetencave të tyre dhe në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute dhe ligjit, janë të detyruar që të sigurojnë integritetin e Kushtetutës.
Në rast të mospajtimit në mes të Kushtetutës dhe një ligji apo dispozitë tjetër juridike, dispozitat e Kushtetutës kanë përparësi, duke qenë detyrë e gjykatave për të vepruar kësisoj edhe **ex officio** në secilin rast.
Divizioni Kushtetues i Tribunalit Suprem të Drejtësisë, si gjykatë me kompetencë kushtetuese, do të ketë autoritet ekskluziv për të shpallur pavlefshmërinë e ligjeve dhe akteve tjera të organeve që ushtrojnë autoritete publike, të cilat janë nxjerrë si pasojë e zbatimit të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm të Kushtetutës apo të cilat kanë fuqinë e ligjit." *Constitution of the Bolivarian Republic of Venezuela (in English translation from the original legal text).* Në internet: http://www. venezuelaemb. or.kr/english/ Constitutiono f the Bolivarianingles.pdf (shikuar në qershor 2017).

17 Neni 4.1. ["Parimet Themelore"] i Kushtetutës: "Kushtetuta paraqet normën e të gjitha normave. Në të gjitha rastet e mospajtimit në mes të Kushtetutës dhe ligjeve apo akteve tjera normative, zbatohen dispozitat kushtetuese[...]".Constitutin of Colombia of 1991 with Amendments through 2005. Në internet: https://www.constituteproject.org/constitution/Colombia_2005.pdf (shikuar në maj 2017).

18 The Constitution of Guatemala of 1985 with Amendments through 1993. Në internet: https:/ /www. constituteproject.org/constitution/Guatemala_1993.pdf (shikuar në qershor 2017).

19 Neni 185 ["Organi Gjyqësor"] i Kushtetutës: "Në kuadër të pushtetit për të administruar drejtësinë, u takon gjykatave që në rastet të cilat duhet t'i gjykojnë të deklarojnë moszbatimin e secilit ligj apo urdhër të ndonjë organi tjetër që është kundër parimeve kushtetuese". *The Constitution of El Salvador of 1983 with Amendments through 2014.* Në Internet : http://extwprlegs1.fao.org/docs/pdf/els127410E.pdf (shikuar në qershor 2017).

20 Honduras's Constitution of 1982 with Amendments through 2012. Në internet : https://www.constituteproject. org/constitution/Honduras_2012.pdf (shikuar në qershor 2017).

21 Constitution of Nicaragua of 1987 with Amendments through 2014. Në internet: https://www.constituteproject. org/constitution/Nicaragua_2014.pdf?lang=en (shikuar në qershor 2017).

rast konkret nuk është në pajtim me Kushtetutën. Kjo çështje mund të ngrihet si nga vetë gjyqtari ashtu dhe nga ndonjëra prej palëve në procedurë[22]. Neni paraprak flet në mënyrë shprehimore për supremacinë (epërsinë) e Kushtetutës, si një detyrë të cilën duhet ta vënë në jetë gjyqtarët në ngarkesë të të cilëve është administrimi i drejtësisë në vend. Formulim shumë i ngjashëm me nenin 4 ["Supremacia Kushtetuese"] të **Ligjit Organik nr. 260** ka ekzistuar në nenin 228 ["Epërsia e Kushtetutës"] të **Kushtetutës së Bolivisë të vitit 2004, në të cilin thuhej si vijon:** "Kushtetuta Politike e Shtetit është ligji suprem i sistemit juridik nacional. Gjykatat, gjyqtarët dhe autoritetet tjera duhet të zbatojnë Kushtetutën para ligjeve, kurse ligjet para akteve tjera juridike".[23]

Sikundër u tha më sipër, cilësia bazike e **modelit difuz (të decentralizuar)** të kontrollit kushtetues është se secili gjyqtar ka për detyrë që të mos zbatojë asnjë ligj apo akt normativ që bie ndesh me kushtetutën gjatë kohës sa është duke zgjedhur apo vendosur një rast apo mosmarrëveshje. Në kuadër të **modelit difuz** (**decentralizuar**) janë zhvilluar edhe disa cilësi tjera të rëndësishme, të cilat këtë model e bëjnë të dallueshëm nga modelet tjera të kontrollit kushtetues. Këto cilësi, të cilat i shpalosim në vijim, zbatohen dhe vlejnë ndaj të gjitha vendeve që përqafojnë **modelin difuz** (**decentralizuar**), ani se nuk kanë qenë objekt i diskutimit tonë këtu. Cilësitë në fjalë kanë të bëjnë me sa vijon:

- karakterin incidental të modelit difuz (**decentralizuar**);
- efektet e prononcimeve mbi jo kushtetutshmërinë; dhe
- mjetet apo instrumentet juridike, siç është instituti **amparo**, të cilat shërbejnë si korrigjues të mosekzistimit kushtetues dhe ligjor të rregullës **stare dcisis,** përkatësisht që shërbejnë për të shtrirë fuqinë detyruese të vendimeve ndaj të gjitha çështjeve kushtetuese të çdo rasti apo mosmarrëveshje analoge që mund të shfaqet në të ardhmen.

Karakteri incidental i **modelit difuz** (decentralizuar) nënkupton disa gjëra. E para, kjo nënkupton se gjyqtari i rastit, **iudex a quo**, është vetëm ai gjyqtar që ka kompetencë sipas fuqisë së kushtetutës dhe ligjit për të vendosur lidhur me një rast apo mosmarrëveshje konkrete. Së dyti, deklarimi jo kushtetues i një norme, ligji apo akti juridik mund të bëhet vetëm në vijim të një gjykimi konkret, i cili është duke u zgjidhur apo vendosur nga ana e gjyqtarit **iudex a quo**, gjyqtarit të rastit. E treta, norma e tillë, ligji apo akti juridik që duhet të zbatohen në një rast apo mosmarrëveshje konkrete nuk është objekt i procesit konkret gjyqësor e as çështje kryesore për t'u vendosur. E cilësisë së tillë është vetëm një çështje konkrete që gjendet për zgjidhje apo vendosje nga ana e gjyqtarit të rastit, **iudex a quo**. Kjo nënkupton, thënë ndryshe, se norma, ligji apo akti juridik kushtetutshmëria e të cilave duhet të vlerësohet me rastin e zgjidhjes apo vendosjes së një rasti apo mosmarrëveshje konkrete duhet të jenë relevante dhe me rëndësi kyçe për rastin apo mosmarrëveshjen e tillë konkrete ashtu që, pa zgjidhjen e kushtetutshmërisë së tyre, nuk mund të ketë mbarim të rastit apo mosmarrëveshjes konkrete. Për këtë arsye, kushtetutshmëria e normës, ligjit apo aktit juridik paraqet vetëm një moment incidental në krejt procesin që zhvillohet pranë **iudex a quo**, gjyqtarit të rastit.

Vlen të theksohet se, në shumicën e vendeve të **Amerikës Latine,** janë palët ato që vetë gjatë procesit konkret gjyqësor duhet t'i ngrehin çështjet e jo kushtetutshmërisë së një norme, ligji apo akti tjetër juridik që duhet të zbatohet në një rast apo mosmarrëveshje konkrete. Në raste shumë të rralla kjo e drejtë i takon gjyqtarit të rastit, **iudex a quo,** si p.sh. në **Venezuelë, Argjentinë** etj.

Një cilësi tjetër tipike e **modelit difuz** (të decentralizuar) të kontrollit të kushtetutshmërisë është efekti **inter partes** i vendimeve dhe prononcimeve tjera të gjykatës lidhur me kushtetutshmërinë e një norme,

---

[22] Artículo 5.1 "Control Constitucional en caso concreto"] : *Ley No. 260 "Ley Orgánica del Poder Judicial de la República de Nicaragua", publicada en La Gaceta, Diario Oficial, No.137 del 23 dé julio de 1998.* Në internet: http://www.poderjudicial.gob.ni/arc-pdf/LOPJ.pdf.

[23] Me Kushtetutën e vitit 2009, nenet 196-2004 ["Gjykata Kushtetuese Plurinacionale "], **Bolivia** ka parashikuar themelimin e **Tribunalit Kushtetues Plurinacional** (**Tribunal Constitucional Plurinacional**). Këtë e diskutojmë më vonë kur flasim për modelin e gjyqësisë së koncentruar kushtetuese i cili ushtrohet nga një gjykatë kushtetuese me juridiksion të vecantë, e ndarë nga gjyqësori i rergullt. *Constitution of Plurinational State of Bolivia of 2009*. Në internet: https://www.constituteproject.org/constitution/ Bolivia 2009.pdf (shikuar në qershor 2017).

ligji apo akti tjetër juridik që duhet të zbatohet në një rast konkret. Kjo nënkupton se deklarata e **iudex a quo,** gjyqtarit të rastit, lidhur me jo kushtetutshmërinë e një norme, ligji apo akti tjetër juridik që duhet të zbatohet në një rast konkret prodhon efekte vetëm për atë rast në të cilin ajo normë, ligj apo akt juridik është shpallur si jo kushtetues. Në parim, jashtë rastit të tillë konkret prononcimi i **iudex a quo,** gjyqtarit të rastit, lidhur me jo kushtetutshmërinë e tillë nuk prodhon efekte. Ky kufizim kësisoj i efekteve të vendimeve apo prononcimeve tjera të gjykatës lidhur me kushtetutshmërinë paraqet pasojë logjike të cilësisë incidentale të **modelit difuz** (të decentralizuar) të kontrollit kushtetues, model në të cilin nënvizohet aspekti konkret i zbatimit të një norme, ligji apo akti juridik me rastin e marrjes së vendimit apo prononcimit lidhur me meritat e rastit nga ana e gjyqtarit të rastit, **iudex a quo**. Efekti **inter partes** quhet ndryshe efekt hapësinor i vendimeve apo prononcimeve të gjyqtarit të rastit, **iudex a quo**[24].

Tjetër efekt është efekti kohor i vendimeve apo prononcimeve të gjyqtarit të rastit, **gjyqtari i rastit (iudex a quo)**. Sa i përket anës kohore të vlefshmërisë së moszbatimit të një norme, ligji apo akti juridik me vlerë jo kushtetuese, gjendja është pak më ndryshe: kur gjyqtari i rastit, **iudex a quo**, konstaton se norma, ligji apo akti juridik që duhet të zbatohet në një rast apo mosmarrëveshje konkrete, është jokushtetues, atëherë vendimi apo prononcimi i gjykatës ka efekt deklarativ. Me këtë efekt nënkuptohet se norma, ligji apo akti juridik **sub iudicio**, të cilat duhet të zbatohen me rastin e zgjidhjes së një rasti apo mosmarrëveshjeje konkrete, shpallen jo kushtetues **ex tunc**, retroaktivisht, përkatësisht merret sikur norma, ligji apo akti juridik **sub iudicio** nuk ka ekzistuar që nga fillimi.

Në fund fare, duhet theksuar se norma, ligji apo akti juridik që nuk është zbatuar në zgjidhjen e një rasti apo mosmarrëveshje konkrete, nuk zbatohet në një rast apo mosmarrëveshje tjetër, qoftë edhe kur **iudex a quo**, gjyqtari i rastit, është i njëjti me atë që ka gjykuar në rastin e vendosjes apo zgjidhjes së mosmarrëveshjes gjatë së cilës është konstatuar jo kushtetutshmëria e normës, ligjit apo aktit juridik **sub iudicio.**

Pyetja, e cila shtrohet tani, është nëse ka mundësi që **modeli difuz** (**decentralizuar**) mund të mbështetet në parimin **stare decisis**, i cili në **SHBA** krijon atë që cilësohet si funksioni **nomofilatik** (unifikues i praktikës gjyqësore në nivel nacional) i gjykatës më të lartë në vend? Ky parim, siç e kemi parë në kapitullin e katërt dhe në kapitujt tjerë paraprakë kur kemi folur për rastin e **GJSSHBA** si dhe për vendet tjera me sistem të përzier, si psh. **Portugalia**, mundëson që vendimet dhe prononcimet e gjykatës më të lartë në vend të kenë efektin e normës, ligjit apo të aktit tjetër juridik për çdo rast apo mosmarrëveshje tjetër të ngjashme, e cila mund të paraqitet në të ardhmen. Deri më tani folëm për dy sistemet, atë të drejtës së përgjithshme (**comon law**) dhe për **sistemin kontinental** apo të së **drejtës civile**. Ta shohim tani si reflektohet efekti i parimit **stare decisis** në modelin e përzier (**decentralizuar**) të sistemit kontinental (**civil**). Kjo nga shkaku se rregulla **stare decisis** është e pakontestueshme në sistemin e **të drejtës së përgjithshme** (**common law**) në ndërkohë që në sistemin e të **drejtës civile** (**sistemi kontinental**), në parim, rregulla **stare decisis** nuk luan rolin e normës, ligjit apo aktit tjetër juridik për rastet apo mosmarrëveshjet e tjera të ngjashme që mund të paraqiten në të ardhmen.

Esenca e kësaj rregulle, e vlefshme pa asnjë rezervë në sistemin ku ka lindur të së drejtës së përgjithshme (**common law**), konsiston në atë se, nëse gjyqtari i rastit (**iudex a quo**) vendos meritorisht për një rast apo mosmarrëveshje dhe, për pasojë, për moszbatimin e asaj norme, ligji apo akti juridik **sub iudicio**, atëherë gjykatat e shkallës së njëjtë apo të shkallës më të ulët detyrohen që në të ardhmen, me kusht që gjenden në praninë e kushteve dhe situatës së ngjashme, të veprojnë në mënyrë të njëjtë siç ka vepruar gjykata e mëparshme. Detyrimi i tillë, i cili ekziston në SHBA dhe në disa vende tjera të sistemit të së drejtës së përgjithshme (**common law**), mundëson që nivelet tjera të gjyqësorit, të njëjta apo më të ulëta se ai që ka vendosur në shkallë të njëjtë, të kenë një standard të njëjtë të vendosjes për të ardhmen kur ndeshën me situatë dhe rast të njëjtë apo të ngjashëm me atë që është vendosur më herët.

---

[24] Roberta Bille, "La giustizia costituzionale nell'America latina". Në Luca Mezzetti (ed.), *SISTEMI E MODELLI DI GIUSTIZIA COSTITUZIONALE* (CEDAM: Padova, 2009) fq. 481-566, në fq. 487.

Në momentin e shpërputhjeve në vendimmarrje, gjykata më e lartë me vendimet apo prononcimet e saj krijon, përmes **stare decisis**, uniformitet dhe zbatim të njëjtë të praktikës gjyqësore në tërë territorin nacional. Në **SHBA**, kjo në veçanti reflektohet si detyrim kur flitet për çështjet kushtetuese që lindin me rastin e vendosjes për një rast apo mosmarrëveshje konkrete. Kështu është edhe në vendet tjera që modelohen sipas sistemit amerikan.[25] Ta shohim se si vendet e **Amerikës Latine** e përdorin rregullën **stare decisis**.

Një dallim i rëndësishëm i **Argjentinës** dhe **SHBA**-ve në lëmin e gjyqësisë kushtetuese është se në **Argjentinë** vendimet e **GJSDA** i obligojnë vetëm palët, jo edhe tjerët që nuk kanë marrë pjesë në gjykim kur është vendosur rasti apo mosmarrëveshja, sepse nuk ekziston një doktrinë **stare decisis** si në **SHBA**. Me kalimin e kohës, megjithatë, **GJSDA** ka arritur t'i bindë gjykatat e ulëta që t'i zbatojnë vendimet e saj në nivel vendi, gjë e cila në shumicën e kohës ka ndodhur dhe ndodhë edhe aktualisht. Kjo do të thotë se në mënyrë efektive, vendimet e **GJSDA** vlejnë në territorin e **Argjentinës** në mënyrë thuajse të njëjtë si në **SHBA** që vlejnë vendimet e Gjykatës Supreme. **Kushtetuta e Argjentinës**, duhet theksuar këtu, nuk parashikon një gjë të tillë, pra që vendimet e **GJSDA** të shërbejnë si **stare decisis** (precedent i detyrueshëm) për nivelin e gjykatave më të ulëta në vend.

Kjo gjendje ka nisur të ndryshojë nga viti 1863, me **Ligjin nr. 48**, i cili ka rregulluar juridiksionin e gjykatave nacionale argjentinase. Sipas këtij ligji, lejohej mundësia e ngritjes së një kërkese të jashtëzakonshme përmes të cilës mund të sfidohej kushtetutshmëria e një vendimi të instancës së fundit në nivel provincial. Kjo mund të bëhej vetëm sa i përket kushtetutshmërisë së një norme, ligji apo akti tjetër juridik të nivelit provincial, situatë e cila ndryshoi me Ligjin nr. 1.893 të vitit 1886 dhe Ligjin nr. 4.055 të vitit 1902, të cilat mundësuan rishikimin përmes kërkesës së jashtëzakonshme, jo vetëm të kushtetutshmërisë së një ligji, norme apo akti tjetër juridik në nivel provincial, por edhe të atyre në nivel federal. Përveç kësaj, sipas kërkesës së jashtëzakonshme lejohej mundësia që të bëhej anulimi i vendimeve të tilla të prekura me deformime kushtetuese. Ky transformim i kërkesës së jashtëzakonshme ka pasur për pasojë, me kalimin e kohës, që ajo të shndërrohet në një instrument për garantimin e supremacisë së ligjeve dhe të kushtetutës federale kundrejt çdo ligji, norme apo akti juridik të nivelit më të ulët. Këtë funksion, pra funksionin e garantimit të supremacisë së ligjit federal dhe Kushtetutës, e ka luajtur **GJSDA** që nga koha e transformimit të tillë të instrumentit juridik të kërkesës së jashtëzakonshme. Në literaturë, ky mjet juridik është cilësuar si një **kasacion kushtetues**.[26]

Nga formulimi i nenit 116 ["Pushteti i Gjyqësorit"] të **Kushtetutës së Argjentinës** të vitit 1853 shihet qartë se **GJSDA** dhe gjykatat më të ulëta kanë pasur juridiksion mbi të gjitha çështjet që përcaktohesh-in me Kushtetutë dhe ligjet e vendit, si dhe mbi marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat **Argjentina** paraqitej si palë. Ky përcaktim kushtetues është i njëjtë me përcaktimin kushtetues amerikan, pra ka shërbyer si bazë për kontrollin kushtetues të decentralizuar (**difuz**), me një dallim që fuqia detyruese e precedentit të **GJSDA** është shumë më e dobët se në rastin amerikan. Kjo vjen si pasojë e faktit që **Argjentina**, megjithatë, ngelet vend me traditën e **sistemit civil** (**kontinental**) të së drejtës ku **stare decisis** (fuqia detyruese e praktikës gjyqësore) nuk është doktrinë dhe ligj i zbatueshëm. Kjo ka bërë që në këtë vend në çështjet kushtetuese shpeshherë të ekzistojnë vendime kundërthënëse dhe të njëjta për çështjet e njëjta apo të ndryshme.

Në **Venezuelë**, gjykata më e lartë në vend, **TSDV**, ushtron një rol të rëndësishëm **nomofilatik** (unifikues i praktikës gjyqësore në nivel nacional). Kjo bëhet përmes sesioneve të brendshme të degëve të karakterit kasacional në çështjet civile, sociale dhe penale. Në këtë kuptim, përveç sesioneve në fjalë, ka raste kur ligjet e shkruara, njëjtë si në **Argjentinë**, parashikonin njohjen e efekteve **stare decisis**. I tillë është rasti me **Kodin e Procedurës Civile të Venezuelës**, sipas të cilit cilësohen si të detyrueshme

[25] Mauro Cappelletti , "Judicial Review in Comparative Perspective". Në *California Law Review* Vol. 58 Issue 5 (October 1970) fq. 1017- 1053 në fq. 1034-1038 dhe 1041 – 1045; Mauro Cappelleti, Mauro Capelletti & William Cohen, *Comparative Constitutional Law. Cases and Materials* (The Bobbs – Merrill Company, Inc.: USA, 1979) fq. 84-85.

[26] Roberta Bille, "La giustizia costituzionale nell'America latina", fq. 489.

vendimet e shkallës së fundit në rastet analoge që kanë të bëjnë me integritetin e legjislacionit dhe uniformitetin e praktikës gjyqësore në nivel vendi. Kjo nënkupton se për çështjet kushtetuese, vendimet dhe prononcimet e organit më të lartë të gjyqësisë në **Venezuelë**, **TSDV**, janë të detyrueshme për të gjitha gjykatat tjera në vend.[27]

Sikundër shihet, në parim, në dy vendet si më sipër, vendimet dhe prononcimet e gjykatave më të larta në vend kanë efekt **inter partes**. Mirëpo, këto efekte shtrihen edhe ndaj aktiviteteve juridiksionale të gjykatave më të ulëta, duke i detyruar ato në respektimin e përmbajtjes së tyre njëjtë sikur të ishin ligje, norma apo akte tjera juridike me rastin e vendosjes apo zgjidhjes së rasteve apo mosmarrëveshjeve analoge (**stare decisis**). Thënë me fjalë tjera, vendimet e **GJSDA** në **Argjentinë** dhe vendimet e sesioneve të **TSDV** në **Venezuelë** kanë natyrë juridike të karakterit të detyrueshëm për gjykatat më të ulëta në nivel nacional.

Megjithatë, **stare decisis** jo çdoherë mund të realizohet në vendet me **sistem difuz** (**decentralizuar**) të kontrollit gjyqësor që i takojnë **sistemit civil** (**kontinental**) të drejtësisë. Nuk ka rëndësi që në disa vende, ta zëmë në **Venezuelë**, jurisprudenca (praktika gjyqësore) e gjykatës më të lartë në vend është në tërësi e detyrueshme për nivelet tjera të gjyqësorit. Jo vetëm kaq! Në shumicën e vendeve gjykatat e shkallës së fundit rrallë herë kanë nevojë të prononcohen për çështjet e caktuara, përkatësisht janë të rralla rastet që përfundojnë në shkallë të fundit për zgjidhje meritore, duke hequr kështu mundësinë e prononcimit të instancës më të lartë gjyqësore në vend lidhur me kushtetutshmërinë e dispozitave juridike në nivel vendi.[28] Për këtë arsye, pra për arsye të pamundësisë për të realizuar unifikimin e legjislacionit nacional në aspektin e kushtetutshmërisë së tij, shumë vende të **Amerikës Latine** kanë futur instrumente dhe mjete të tjera juridike me qëllim të zgjidhjes së pasigurisë dhe kontrasteve nga aspekti kushtetues që zbulohen në nivel të legjislacionit nacional. Në këto mjete juridike apo instrumente me të cilat karakterizohen vendet e **Amerikës Latine** dhe që janë futur me qëllim të sigurimit të efekteve **stare decisis** në çështjet kushtetuese hyn instituti i njohur që ngjason me ankesën kushtetuese, instituti **amparo**, i cili ekziston në të gjitha vendet e **Amerikës Latine** (me përjashtim të **Kubës**).[29]

Futja e institutit **amparo** në këto vende e ka transformuar në tërësi sistemin e gjyqësisë kushtetuese. Në fakt, **amparo** ka transformuar krejt sistemin e gjyqësisë kushtetuese në **Amerikën Latine,** duke i larguar nga përvoja amerikane fillestare të cilën disa vende latine-amerikane e kishin përqafuar përgjatë kohëve të kaluara. Me **amparo**, ndër tjera, mund të vihej në lëvizje gjyqësia (e rregullt apo kushtetuese) me qëllim të mbrojtjes të të drejtave dhe lirive njerëzore *vis-a-vis* autoritetit shtetëror, qoftë duke sfiduar aktet individuale (gjyqësore apo administrative) apo duke kontestuar kushtetutshmërinë e një ligji apo akti tjetër juridik (ndaras si juridiksion origjinal apo përmes procedurës së kontrollit kushtetues incidental). Përveç **amparo**, në vendet e **Amerikës Latine** janë krijuar edhe institute tjera që kanë për qëllim zbutjen e efekteve negative të cilat lindin si pasojë e mosekzistimit të rregullës **stare decisis** në këto vende. I një natyrë të tillë është instituti i **habeas corpus** me të gjitha format e manifestimit të tij.[30]

---

27 Ibid.

28 Patricio Navia **&** Julio Rios - Figueroa, "The Constitutional Adjudication Mosaic of Latin America." *Comparative Political Studies* Vol. 38 Issue 2 (2005) fq. 189-217 në fq. 171.

29 Në **Argjentinë**, ankesa **amparo** është futur më 1853, me Kushtetutën Federale, mirëpo në praktikë Gjykata Supreme ka nisur t'i ushtrojë kompetencat lidhur me amparo në vitin 1860. **Meksiko** , në këtë mënyrë, konsiderohet si vendi i parë që e ka vënë në jetë për të parë institutin e ankesës kushtetuese amparo më 5 shkurt 1857, dhe e ka paraparë edhe në Kushtetutën e vitit 1917. Më pastaj, **amparo** është futur edhe në rendet kushtetuese të disa vendeve tjera latine-amerikane, si: **Guatemala** me Kushtetutën e vitit 1965 dhe me Ligjin për Amparo të vitit 1966, **Hondurasi** me Kushtetutën e vitit 1982 dhe Ligjin për Amparo të vitit 1936, i amendamentuar më 1982 dhe, së fundi, **Nikaragua** me Kushtetutën e vitit 1979 dhe me Ligjin për të Drejtat dhe Garancionet të vitit 1979 dhe Ligjin për Amparo të vitit 1980. Cf. Axel Tschentscher and Caroline Lehner, "The Latin American Model of Constitutional Jurisdiction: Amparo and Judicial Review (July 19, 2013)." fq. 1-30 në fq. 6. Në internet SSRN: https://ssrn.com/abstract= 2296004 or http://dx. doi. org/ 10.2139/ssrn.2296004.

30 Cf. Roberta Bille, "La giustizia costituzionale nell'America latina", fq. 540-550.

6.2. Modeli i koncentruar (centralizuar) pa gjykatë të ndarë kushtetuese

Në këtë model, kontrolli ushtrohet nga një organ, i cili në hierarkinë e gjyqësorit zë pozitën më të lartë. Në gjirin e këtij organi ekziston një dhomë (departament, trup) e posaçme që sipas kushtetutës nacionale ka të drejtën ekskluzive për të ushtruar kontrollin e kushtetutshmërisë dhe për të thënë fjalën e fundit në çdo çështje kushtetuese. Organi i tillë ka emërtime të ndryshme. Zakonisht quhet gjykatë supreme, por mund të ketë edhe emërtime tjera. Ajo çfarë e dallon këtë sistem nga ai ku ka gjykatë të ndarë kushtetuese, është vetëm zgjidhja institucionale, asgjë tjetër: në rastin e parë ekziston një gjykatë e ndarë kushtetuese, kurse në të dytin një e tillë nuk ekziston.

Në dy modelet, megjithatë, efektet e vendimeve dhe natyra e tyre juridike janë të njëjta, kurse juridiksioni është i përcaktuar me kushtetutë nacionale në mënyrë krejt taksative. I vetmi dallim, thënë ndryshe, qëndron në atë se, në rastin aktual të sistemit të koncentruar pa gjykatë të ndarë kushtetuese, juridiksioni kushtetues ushtrohet nga një gjykatë e rregullt, e cila është më e larta në hierarkinë gjyqësore, juridiksion që është i përcaktuar me kushtetutën nacionale. Në rastin që diskutohet këtu, ndërkaq, pra të modelit të koncentruar pa gjykatë të ndarë kushtetuese, juridiksioni i gjykatës kushtetuese përcaktohet me kushtetutë dhe ushtrohet nga një organ i ndarë dhe i specializuar për shqyrtim dhe vendosje ekskluzivisht në çështjet kushtetuese në nivel vendi. Ka raste kur gjykata nacionale kushtetuese është në kuadër të sistemit gjyqësor dhe kushtetuta e trajton si të tillë[31]. Ka raste, ani se pak më të rralla, kur me kushtetutë nacionale përcaktohet një gjykatë kushtetuese, tërësisht e ndarë nga sistemi i gjyqësorit të rregull në nivel nacional, që ushtron kontrollin e kushtetutshmërisë.[32] Modeli më i përhapur në **Amerikën Latine**, megjithatë, është modeli aktual, pra ai i kontrollit të koncentruar (**centralizuar**) të kushtetutshmërisë pa një gjykatë të ndarë kushtetuese. Përhapja e tij ka ardhur si rezultat i një transformimi përgjatë shekujve të gjyqësisë kushtetuese në këto vende, aq shumë sa, në literaturë, flitet për një përafrim në një mase të madhe në mes të **sistemit amerikan** dhe atij **kelsenian/evropian**. Në fakt, vështirë se sot mund të bëhet një dallim krejt i rrept dhe i prerë në mes të këtyre dy modeleve, jo vetëm në vendet e **Amerikës Latine,** por edhe në nivel botëror[33].

Në vendet e **Amerikës Latine** ku nuk ka një gjykatë kushtetuese të ndarë dhe të veçantë nga juridiksioni i gjykatës më të lartë të rregullt në nivel nacional, por që ekziston një kontroll i koncentruar (**centralizuar**) i kushtetutshmërisë, bëjnë pjesë, ndër tjera, **Brazili**, **El Salvadori, Hondurasi**, **Kosta Rika**, **Meksiko, Nikaragua, Panama**, **Paraguaji**, **Urugvaji** dhe, në fund, **Venezuela**. Në këto vende, me fjalë tjera, sipas kushtetutave nacionale ekziston një juridiksion i qartë kushtetues që dallon nga juridiksioni i përgjithshëm civil, administrativ dhe penal, por që ushtrohet nga instanca më e lartë e gjyqësorit të rregullt në vend, pra jo nga një gjykatë e ndarë kushtetuese. Në këto raste, gjyqësia kushtetuese është vetëm një hallkë më e lartë, apo më e larta, në organizimin vertikal të gjyqësorit të rregullt. Siç u konstatua më sipër, në kuadër të këtyre vendeve ekziston akoma edhe sistemi i kontrollit incidental (konkret) të kushtetutshmërisë ku gjyqtari ka të drejtën e mosaplikimit të një ligji, norme apo akti juridik në një rast konkret, mirëpo fjalën e fundit në çështjet kushtetuese në mënyrë autoritative sërish e ka organi më i lartë në hierarkinë gjyqësore në nivel nacional, të cilit i takon e drejta ekskluzive për t'u dhënë fjalën autoritative lidhur me kushtetutshmërinë e një ligji, norme, akti juridik apo tjetër.

---

[31] Në këtë grup hyjnë si vende më të spikatura **Guatemala**, **Kolumbia**, **Ekuadori**, **Bolivia**, **Kili** dhe **Peru**. pra si vende ku gjykata kushtetuese është pjesë e sistemit gjyqësor. Mirëpo, edhe në këto vende gjykata kushtetuese nuk është në vijë vertikale pjesë e gjyqësorit të rregullt, por paraqitet si një juridiksion i veçantë dhe i ndarë, i specializuar në krahasim me juridiksion e përgjithshëm të gjykatave të rregullta (juridiksionin administrative, penal dhe civil).

[32] Në këtë grup hyjnë si vende më karakteristike **Kili** dhe **Peruja**, pra si vende ku gjykata kushtetuese edhe formalisht nuk bën pjesë në kuadër të sistemit të rregullt gjyqësor, por paraqitet si e veçantë dhe e specializuar në vetë tekstin kushtetues, duke mos pasur asnjë asocim me gjyqësorin e rregullt.

[33] Shih për këtë më shumë në studimin analitik të Francisco Fernandez Segado, "La giustizia costitutzionale nel XXI secolo. Il progressivo avvicinamento dei sistemi americano ed europeo-kelseniano". *Center for Constitutional Studies and Democratic Development Lecture Series* (CLUEB: Bologna, 2010).

Në literaturë dhe në diskursin e përgjithshëm mbi gjyqësinë kushtetuese si "gjykatë kushtetuese" konsiderohen edhe gjykatat më të larta të gjyqësorit të rregullt në vend, të cilat ushtrojnë juridiksion kushtetues sipas kushteve të përcaktuara me kushtetutë dhe akte tjera juridike në vend. Jo vetëm kaq! Termi "gjykatë kushtetuese" i referohet zakonisht çdo mekanizmi dhe aktiviteti që ka për qëllim sigurimin dhe ruajtjen e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës dhe rendit të bazuar në të krahasuar me çdo akt tjetër dhe rend juridik më të ulët se ai i përcaktuar me kushtetutë.

Veçori e sistemit të koncentruar, me apo pa gjykatë të ndarë kushtetuese, është se gjyqtari dhe gjykata kompetente janë të veshur me **autorizime ablative.** Me këtë nënkuptohet e drejta e gjykatës për të hequr nga rendi kushtetues të atyre normave që janë cilësuar si jo kushtetuese. Për këtë arsye ka rëndësi që gjykatat e rregullta të instancës më të lartë, apo gjykatat e ndara kushtetuese, të jenë të veshura në mënyrë shprehimore me një autorizim të tillë të natyrës **ablative**.

Brazili, njëjtë sikur Meksiko, nuk ka një gjykatë kushtetuese më juridiksion të veçantë kushtetues dhe të ndarë nga gjyqësori i rregullt. Kapitulli III i Kushtetutës së Brazilit të vitit 1988, e cila aktualisht është në fuqi dhe paraqet kushtetutën e shtatë të këtij vendi nga lindja e tij më 1822, ka dy seksione dhe shtrihet në nenet 91-103 B të Kushtetutës. Seksioni i parë flet për gjyqësorin brazilian në përgjithësi, kurse seksioni i dytë në mënyrë specifike rregullon statusin, pozitën dhe juridiksionin e **Tribunalit Suprem Federal** (**TSFB**). Në këtë vend, njëjtë si në sistemin amerikan, parashihet mundësia që secila gjykatë e rregullt të mund të vendosë për kushtetutshmërinë e një ligji apo një dekreti gjatë kohës sa është duke vendosur apo zgjidhur një rast apo mosmarrëveshje në mes palëve[34]. Vendimi i gjykatës në rastet e tilla ka efekt **inter partes**.[35] Nga kjo rregull, megjithatë, ka përjashtim. Ai përjashtim është futur me reformën e thellë kushtetuese që ka çuar në miratimin nga fillimi të Kushtetutës aktuale më 5 tetor të vitit 1988. Kjo reformë ka zgjeruar dukshëm qasjen në gjykata në shumë aspekte dhe drejtime, gjë që ka pasur për pasojë edhe në ndryshimin e efekteve dhe natyrës juridike të vendimeve gjyqësore në çështjet kushtetuese.

Një ndër këto ndryshime është edhe mundësia për të vendosur për kushtetutshmërinë apriori të ligjeve dhe akteve juridike përmes të a.q. veprimeve direkte lidhur me kushtetutshmërinë. Këto veprime direkte, sipas nenit 102. I. a. ["Tribunali Suprem Federal"] të Kushtetutës, vejnë në lëvizje juridiksionin origjinal kushtetues të **TSFB**, i cili ka të bëjë me autorizimin e **TSFB** për të shqyrtuar dhe vendosur, **inter alia**, mbi kushtetutshmërinë e akteve federale apo shtetërore normative. Palët që mund ta vejnë në lëvizje këtë juridiksion të **TSFB**, sipas nenit 103 të Kushtetutës, janë: Presidenti i Republikës, Komiteti Ekzekutiv i Senatit Federal, Komiteti Ekzekutiv i Dhomës së Deputetëve, Komiteti Ekzekutiv i Asamblesë Legjislative ose Dhoma Legjislative e Distriktit Federal, Guverneri i Shtetit apo i Distriktit Federal, Prokurori i Përgjithshëm, Këshilli Federal i Dhomës së Avokatëve të Brazilit, dhe Partia Politike e Përfaqësuar në Kongres[36]. Përveç kësaj, me amendamentet e vitit 1993, është futur edhe një rrugë tjetër e qasjes në **TSFB**, përkatësisht i a.q. veprimi deklarativ i kushtetutshmërisë. Sipas këtij mjeti, **TSFB** mund të vendosë lidhur me kushtetutshmërinë e një politike qeveritare. Palë të autorizuara për të vënë në lëvizje këtë lloj procedure janë: Presidenti, Kongresi dhe Prokurori i Përgjithshëm. Sipas këtyre amendamenteve, deklarata mbi kushtetutshmërinë ka efekt **erga omnes** dhe nuk mund të sfidohet në gjykatat më të ulëta.

TSFB vepron si një gjykatë e apelit në rastet e kontrollit **a posteriori** të kushtetutshmërisë. Kjo parashihet në nenin 102 paragrafi II (nën "a" & "b") dhe III (nën "a" deri "d") të Kushtetutës. **TSFB** duhet t'i pranojë të gjitha ankesat dhe nuk ka diskrecion në vendosje, siç ka **GSSHBA** (instituti i a.q. **certiorari** në SHBA). Në parim, vendimet e **TSFB** kanë karakter **inter partes**, siç u konstatua më herët. Pra, në parim,

---

[34] Neni 97 i Kapitullit III ["Dispozitat e Përgjithshme të Gjyqësorit"] i Kushtetutës parashikon se gjykata mund të shpallin jo kushtetues ligjet dhe aktet tjera normative me votën e shumicës absolute të anëtarëve të tyre ose të anëtarëve të përbërjes speciale të gjykatës.

[35] Keith S. Rosenn, "Judicial Review in Brazil: Developments under the 1988 Constitution." *Southwestern University Journal of Law and Trade in Americas* Vol. 7 (2000) fq. 291-319 në fq. 293–4.

[36] *Constitution of Brasil of 1988 with Amendments through 2014.* Në internet : https:/ /www.constituteproject. org/ constitution/ Brazil_2014.pdf (shikuar në maj 2017).

vendimi i **TSFB** nuk ka një efekt **erga omnes.** Po ashtu, përveç rasteve shumë të rralla, vendimet e **TSFB** nuk kanë efekt detyrues për gjykatat e nivelit më të ulët në vend. Natyra juridike e forcës detyruese të precedentëve, në rendin kushtetues brazilian ka filluar në mesin e viteve '60 të shekullit të kaluar,[37] kurse është bërë standard me nenin 103 a të Kushtetutës së amenadamentuar në vitin 2004.

Këto precedente të detyrueshme njihen me emrin kushtetues **sumula**, të cilat paraqesin ripërsëritje të qëndrimit më mbizotërues të **TSFB** lidhur me një çështje të caktuar juridike që ka fuqi të madhe bindëse dhe mund të shërbej si standard për vendosjen e rasteve të ngjashme në të ardhmen. Ky autorizim i mundëson **TSFB** që përmes **sumula**, e cila ka të bëjë me çështje kushtetuese, të shpallë si precedent të detyrueshëm për gjykatat e ulëta një vendim **a posteriori** së bashku me arsyetimin e tij[38]. Reformat kushtetuese që kanë çuar në miratimin e Kushtetutës së vitit 1988, kanë ofruar qasje më të madhe në **TSFB**. Në të njëjtën kohë, megjithatë, ka shumë pak mundësi për t'i përdorur precedentet e tij si të detyrueshme në çështjet kushtetuese për gjykatat dhe organet tjera, siç është rasti me fuqinë detyruese të precedenteve të **GJSSHBA** (**stare decisis**). Thënë ndryshe, fakti që vendimet e **TSFB** vazhdojnë të kenë kryesisht efekt **inter partes**, përveç rasteve të sipërcekura të **sumula-**ve, kanë çuar deri te një zgjidhje specifike të kontrollit të kushtetutshmërisë në këtë vend që e bën më të ndryshëm se modeli amerikan, ani se në esencë modelohet sipas tij, historikisht shikuar. Fakti se **TSFB** nuk ka diskrecion për të vendosur për zgjidhen e rasteve, mungesa e precdentit të detyrueshëm, mundësi për qasje në **TSFB**, me një fjalë, janë faktorët që kanë çuar deri te mbingarkimi me punë dhe me raste të reja të **TSFB** përtej çdo mase[39].

Në **El Salvador** ka pasur një ngritje progresive të kontrollit të koncentruar (**centralizuar**) të kushtetutshmërisë, me fillim që nga **Kushtetuta e El Savadorit** e vitit 1950. Me këtë Kushtetutë, **Gjykatës Supreme të Drejtësisë** (**GJSDE**) iu njoh e drejta për të vendosur lidhur me jokushtetutshmërinë e normave juridike. Kjo porcedurë mund të vihej në lëvizje me **actio popularis**. Me Kushtetutën e vitit 1983, megjithatë, u bë progres i dukshëm dhe i qartë në lëmin e kontrollit të koncentruar (**centralizuar**) të kushtetutshmërisë në këtë vend: neni 174 ["Organi Gjyqësor"] të Kushtetutës mundësoi që **GJSDE** të specializohet në çështjet kushtetuese përmes krijimit të një divizion të veçantë kushtetues në gjirin e saj. Ky divizion kushtetues i **GJSDE** ka në kompetencë të vetin këto çështje:

"Gjykata Supreme e Drejtësisë do të ketë një divizion kushtetues, i cili ka kompetencë për të marrë në dijeni dhe për të vendosur peticionet lidhur me jo kushtetutshmërinë e ligjeve, dekreteve dhe rregullave, rasteve sipas kërkesës amparo, habeas corpus, konfliktet për kompetencë në mes të legjislativit dhe ekzekutivit për të cilat flitet në nenin 138, si dhe lidhur me paditë që përmenden në pikën e 7-të (**atribucion**) të nenit 182 të kësaj Kushtetute [...]."

Kushtetuta e Hondurasit e vitit 1894 në nenin e saj 128 ka parashikuar detyrimin e **Gjykatës Supreme të Drejtësisë** (**GJSDH**) që të shpallë jokushtetutshmërinë e ligjeve. Kjo zgjidhje kushtetuese më pastaj është vërtetuar në kushtetutat sukcesive, përfshirë këtu Kushtetutën e vitit 1982, e amendamentuar disa herë pas hyrjes së saj në fuqi[40]. Në nenin 184 ["Vlerësimi i Jokushtetutshmërisë"], kjo Kushtetutë, aktualisht në fuqi, parashikon si vijon:

"Ligjet mund të shpallen jokushtetuese si për shkak të formës ashtu edhe për shkak të përmbajtjes së tyre".
Gjykata Supreme e Drejtësisë ka juridiksion origjinal dhe ekskluziv për të dëgjuar dhe vendosur rastet e

---

37 Miguel-Stearns, Teresa M., "Judicial Power in Latin America: a Short Survey", fq. 102.

38 Paragrafi i parë i nenit 103 A ["Tribunali Suprem Federal"] i Kushtetutës: "Me vendimin e dy të tretave të anëtarëve të vet, pas vendimeve të përsëritura për çështje kushtetuese, Tribunali Suprem Federal, **ex officio** apo sipas kërkesës, mund të aprovojë **sumula** të tilla, të cilat, pas publikimit në gazetën zyrtare, do të kenë efekt detyrues në organet tjera të gjyqësorit dhe në ato në nivel federal, shtetëror dhe në nivel të administratës komunale, të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë. Tribunali Suprem Federal po ashtu mund të ndryshojë apo anulojë **sumula**-t e tij në mënyrën e përcaktuar me ligj [...]".

39 Miguel-Stearns, Teresa M., "Judicial Power in Latin America: a Short Survey", fq. 105.

40 *Constitution of Honduras of 1982 with Amendments through 2013.* Në internet: https://www.constituteproject. org/constitution/Honduras_2013.pdf?lang=en (shikuar në korrik 2017).

tilla dhe duhet të japë vendimet e veta në pajtim me kushtet që kërkohen për shqiptimin e aktgjykimeve përfundimtare".

Nga dispozitat e nenit në vijim, nenit 185 i Kushtetutës, më së miri shihet natyra juridike dhe efektet e **actio popularis** si dhe esenca e kontrollit të koncentruar (**centralizuar**) të kushtetutshmërisë. Në paragrafin e parë të këtij neni, përcaktohet se, çdokush që konsideron se është i dëmtuar në interesat e vetë të drejtpërdrejtë, personal dhe legjitim, mund të parashtrojë **actio popularis**, në pajtim me pikat 1 deri 3 të këtij paragrafi, ndaj:

- procedurave që zhvillohen pranë **GJSDH**;
- si mjet mbrojtjeje në çdo fazë të procedurave juridike; dhe
- përveç palës së dëmtuar si më sipër, vetë gjykata në çdo fazë të gjykimit mund të kërkojë shpalljen si jo kushtetues të një ligji, si dhe moszbatimin e tij para se të vendoset lidhur me rastin konkret që ndodhet pranë saj.

Në dy situatat e fundit, procedurat e kontrollit të kushtetutshmërisë do të ngrihen deri sa të jepet vendimi nga ana e **GJSDH**, e cila është e vetmja me kompetencë ekskluzive dhe autoriteti i fundit për të vendosur lidhur me kushtetutshmërinë e ligjeve. Në ndërkohë që pritet vendimi i **GJSDH**, bëhet pezullimi i procedurave pranë gjykatave tjera deri në vendosjen për kushtetutshmërinë e ligjit. Kjo tregon se fjala është për një sistem të koncentruar (**decentralizuar**) të vlerësimit të kushtetutshmërisë së ligjeve.

Në **Kosta Rika**, përqafimi i modelit të **kontrollit të koncentruar** (**centralizuar**) të gjyqësisë kushtetuese ka kaluar nëpër disa faza. Si kontroll gjyqësor, ai ka nisur më 1936 me hyrjen në fuqi të **Kodit të Procedurës Civile**. Në literaturë është vërejtur se, megjithatë, në kohën e sundimit spanjoll, në këtë vend, sikundër dhe në vendet tjera të **Amerikës Latine**, ka vlejtur Kushtetuta e Spanjës e vitit 1812, e njohur si **Kushtetuta e Kadizit.** Ndikimi i kësaj kushtetute ka bërë që edhe pas fitimit të pavarësisë së **Kosta Rikës** më 1821, të vazhdojë ende për disa dekada të vlejë kontrolli politik i kushtetutshmërisë, i modeluar nën ndikimin francez të kohës. Në këtë mënyrë, në fazën e parë të zhvillimit të konstitucionalizmit në këtë vend ka vlejtur e njëjta kushtetutë, si në vendet tjera nën sundimin spanjoll në Amerikën Qendrore.

Në fazën e dytë, e cila fillon me Kushtetutën e vitit 1871 të këtij vendi, nis faza e kontrollit gjyqësor difuziv (**decentralizuar**), i modeluar sipas ndikimit amerikan. Mirëpo, vendimet gjyqësore të gjykatave nuk kishin efekt precedenti sepse vlenin vetëm **inter partes.** Vetëm më vonë, në fazën e tretë, me nxjerrjen e Kushtetutës së vitit 1949, kontrolli kushtetues ka fituar cilësi të pastra të juridiksionit kushtetues të përcaktuar me tekstin kushtetues: që nga atëherë, **Gjykata Supreme e Drejtësisë në Kostarikë** (**GJSDK**) ka marr autorizim për të vlerësuar kushtetutshmërinë e ligjeve, akteve dhe veprimeve të tjera juridike në rrugë të drejtpërdrejtë dhe ekskluzive, njëjtë siç e bëjnë gjykatat e ndara kushtetuese në sistemin **evropian/kelsenian**. Në fillim, ky juridiksion është ushtruar nga **GJSDK** si tërësi, kurse, me ndryshimet kushtetuese të vitit 1989, është krijuar një dhomë e veçantë kushtetuese brenda **GJSDK**, e njohur si **Sala Constitucional**[41]. Këto ndryshime kushtetuese kanë krijuar një juridiksionin të fuqishëm dhe të gjerë të kontrollit të centralizuar të kushtetutshmërisë.[42]

Ndryshimi në juridiksion u reflektua në nenin 10 të kapitullit të parë ["Republika"] të Kushtetutës së vitit 1989, aktualisht në fuqi. Në këtë nen përcaktohet autorizimi për interpretim të Kushtetutës dhe për vlerësim të kushtetutshmërisë së legjislacionit të **Kosta Rikës** nga ana e një dhome të specializuar për çështje kushtetuese. Aty përcaktohet si vijon:

---

41 *Constitution of Costa Rica of 1949 with Amendments through 2011*. Në internet: https:// www.constituteproject. org/constitution/Costa_Rica_2011.pdf?lang=en (shikuar në qershor 2017).

42 Për të gjitha fazat e zhvillimit kushtetues, me fillim që nga koha e kolonializmit spanjoll e deri në kohët moderne, shih më shumë në Olman A. Rodriguez L., "The Costa Rican Constitutional Jurisdiction*" Duquesne Law Review* Vol. 49 No. 2 (Spring 2011) fq. 243-292 në fq. 269-274.

"Një dhomë të specializuar të Gjykatës Supreme të Drejtësisë do të ketë të drejtën e deklarimit, me një shumicë absolute të anëtarëve të saj, jokushtetutshmërinë e normave të çfarëdo natyre dhe të akteve të cilat i nënshtrohen të drejtës publike. Aktet juridiksionale të pushtetit gjyqësor, shpallja e zgjedhjeve e kryer nga Tribunali Suprem i Zgjedhjeve si dhe çështjet tjera të përcaktuara me ligj, nuk mund të sfidohen në këtë dhomë.

Po ashtu, në kompetencë të kësaj Dhome do të bien edhe:

"a. Zgjedhja e konflikteve për kompetencë në mes të pushteteve të shtetit, Tribunalit Suprem të Zgjedhjeve, si dhe të konflikteve me entitetet tjera apo organet që përcaktohen me ligj; dhe

b. Marrja në dijeni e konsultimeve lidhur me ligjet që kanë të bëjnë me reformën kushtetuese, miratimin e marrëveshjeve ndërkombëtare apo traktateve si dhe me ligjet tjera ashtu siç përcaktohet me ligj".

Sikundër vërehet, juridiksioni i kësaj dhome të specializuar për çështje kushtetuese është i ngushtë dhe nuk përfshin aktet individuale të pushtetit gjyqësor. Kjo sepse, kur flitet për të drejtat e njeriut, mbrojtja e tyre rregullohet me **amparo** dhe me mjete tjera juridike, të cilat ekzistojnë në këtë vend dhe në vendet e Amerikës Latine dhe që kanë për qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe lirive njerëzore të garantuara me kushtetutë.

Në rastin e **Kosta Rikës**, kjo përcaktohet në mënyrë shprehimore me nenin 48 ["Të Drejtat Individuale dhe Garancionet"] të Kushtetutës, ku garantohet e drejta e habeas corpus dhe e amparos me qëllim "[...] të ruajtjes apo rikrijimit të mundësisë për gëzim të të drejtave të garantuara me këtë Kushtetutë, si dhe të drejtave fundamentale të pranuara me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që zbatohen në Republikë [...]".

Me **Ligjin nr. 7. 135 për Juridiksionin Kushtetues në Kosta Rikë** të datës 18 tetor 1989, në detaje rregullohet dhe shtjellohet akoma më tutje juridiksioni kushtetues, mënyra e ushtrimit të tij, palët e autorizuara si dhe çështjet tjera lidhur me të. Në fakt, Ligji, i miratuar si pjesë e reformës kushtetuese të viti 1989, më tutje ka zgjeruar juridiksion kushtetues të dhomës së veçantë kushtetuese, **Sala Constitucional**. Ky zgjerim tani përfshin jo vetëm mbrojtjen e normave kushtetuese, por edhe të parimeve kushtetuese, sikundër edhe të normave dhe parimeve të së drejtës ndërkombëtare që janë në fuqi në **Kosta Rikë**. Vendimet lidhur me jokushtetutshmërinë, përfshirë edhe në procedurat e **habeas corpus** dhe **amparo** kanë efekt të precedenteve të detyrueshme erga omnes për tjerët, përveç për **Sala Constitucional.**[43]

Rasti i **Meksikos**, jo pa arsye, përbën një rast mjaft specifik krahasuar me tjerët. Kjo sepse, deri në reformën e vitit 1994[44], **Kushtetuta e Meksikos** e vitit 1917, e cila me amendamentime të shumta është sot në fuqi,[45] nuk ia ka njohur **Gjykata Supreme e Drejtësisë në Vend** (GJSDM) të drejtën e kontrollit gjyqësor të veprimeve të legjislativit dhe të organeve tjera të pushtetit. Kjo mosnjohje konsiston në faktin se Kushtetuta e vitit 1917, për nga natyra e saj është, në thelb, transformative. Me këtë nënkuptohet se ajo në nisje ka qenë e projektuar si një dokument që duhet të bëj të mundur transformimin socio-ekonomik dhe tjetër të shoqërisë meksikane. E nisur nga kjo natyrë e Kushtetutës, shoqëria meksikane në mënyrë unanime i hoqi gjyqësorit të drejtën e kontrollit të veprimeve të legjislativit dhe organeve të tjera të pushtetit, bazuar në përvojat e këqija në **SHBA**. Me përvoja të këqija në këtë

[43] Michael B. Wise, "Judicial Review and Its Politicization in Central America: Guatemala, Costa Rica, and Constitutional Limits on Presidential Candidates". *Santa Clara Journal of International Law* Vol. 7 Issue 2 (2010) fq. 145-180 , në fq. 167-168.

[44] Reforma ka nisur në dhjetor të vitit 1994, kurse janë sanksionuar me ligj në shkurt të vitit në vijim. Cf. Miguel Schor, "An Essay on the Emergence of Constitutional Courts: The Cases of Mexico and Columbia". *Indiana Journal of Global Legal Studies* Volume 16 Issue 1 (Winter 2009) fq. 173-194 në fq. 180.

[45] Në periudhën prej vitit 1917 deri më 1988, pra para ndryshimeve të vitit 1994, Kushtetuta e vitit 1917 është amendamentuar mbi katërqind herë. Ibid. fq. 180 (fusnota nr. 38).

kontekst nënkuptohet rasti i njohur **Lochner vs. New York** (1905),[46] në të cilin **Gjykata Supreme** pengoi zhvillimin progresiv të disa proceseve socio-ekonomike dhe proceseve të tjera në shoqërinë amerikane.[47]

Me reformat e vitit 1994, gjykata më e lart në këtë vend, **GJSDM**, ka pësuar një rilindje në lëmin e gjyqësisë kushtetuese, duke fituar autorizime të kontrollit të drejtpërdrejtë dhe të koncentruar (**centralizuar**) të kushtetutshmërisë.[48] **GJSDM** nuk ka krijuar në kuadër të saj një dhomë të specializuar për çështje kushtetuese: nga kjo reformë, si gjykatë më e lartë në vend, ajo luan rolin e gjykatës kushtetuese në tërësinë e saj.[49] Ky rol shprehet, sipas **Kushtetutës së Meksikos** të vitit 1917, aktualisht në fuqi[50], në të drejtën e **GJSDV** për të shpallur normat juridike si jokushtetuese me efekt **erga omnes** për të ardhmen. Kontrolli i kushtetutshmërisë aktualisht realizohet përmes tre instrumenteve apo procedurave. I pari quhet "kërkesës për kontroll abstrakt të jokushtetushmërinë e ligjeve", i dyti "kërkesë në kontestet kushtetuese" dhe, i treti, kërkesa **amparo**.[51] Kontrolli i kushtetutshmërisë, i cili realizohet përmes këtyre tri instrumenteve apo procedurave, tani përbën një autorizim ekskluziv që nuk i takon asnjë gjykate tjetër në vend pos **GJSDM**. Kjo nuk ndryshon asgjë në faktin se **GJSDM** akoma ngelet në nivel vertikal autoriteti më i lartë dhe i fundit nacional në të gjitha çështjet administrative, civile dhe penale dhe as rrethana që **GJSDM** akoma ka autorizim të vetëm që, në gjykimet sipas kërkesës **amparo**, mos të zbatojë normën juridike e cila duhet të zbatohet në një rast apo mosmarrëveshje konkrete.

Kontrolli abstrakt i kushtetutshmërisë si një prerogativë ekskluzive e **GJSDM** realizohet përmes ushtrimit të kërkesës për kontrollin e jokushtetutshmërisë së ligjeve. Kjo parashikohet në nenin 105. II ["Pushteti Gjyqësor"] të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite, të autorizuar për të ushtruar këtë kërkesë, janë: 1. një përqindje prej 33 nga anëtarët e organeve legjislative në nivel të shteteve anëtare apo në nivel federal; 2. prokurori i përgjithshëm i Republikës; partitë politike; 4. avokati i popullit (ombudspersoni); qoftë nacional apo i shteteve anëtare të federatës meksikane.

---

46 Epoka e njohur si **Lochner** në jurisprudencën amerikane është periudha nga viti 1897-1937. Në këtë periudhë Gjykata Supreme e SHBA-ve, ani se ishte politikisht konservative, në pikëpamje gjyqësore u tregua mjaft aktiviste përmes anulimit të rregullativës ekonomike të miratuara nga shtetet anëtare . Ky anulim i veprimeve legjislative të shteteve anëtare bëhej mbi bazën e botëkuptimeve autonome të Gjykatës Supreme lidhur me atë se cilat duhej të ishin mjetet më të përshtatshme të shteteve për implementimin e politikave të caktuara. Do të thotë, Gjykata Supreme përcaktonte vetë mjetet të cilat duheshin përdorur për të vënë në jetë politikat e caktuara shtetërore në lëmin ekonomik dhe të lirisë së kontraktimit. Kjo epokë quhet Lochner sipas rastit të vendosur më 1905, me vendimin në rastin **Lochner v. New York** (1905), mirëpo ka nisur më herët me shqiptimin e vendimit në rastin **Allgeyer v. Louisiana** (1897), në ndërkohë që ka [përfunduar dyzet vite më vonë me rastin e njohur si **West Coast Hotel Co. v. Parrish** (1937), i cili ka përmbysur vendimin në rastin **Lochner.** Cf. më shumë në Howard Gillman, *The Constitution Besiged. The Rise and Demise of Lochner Era Police Powers Jurisprudence* (Duke University Press: Durham, North Carolina, 1995) dhe Paul Kens, *Lochner v. New York: Economic Regulation on Trial* (University Press of Kansas: Lawrence, Kansas 1998) (ku autorët argumentojnë se rasti **Lochner,** i nisur në fakt si praktikë mjaft më herët, kishte vënë kundër legjislativit progresiv të shteteve amerikane një praktikë gjyqësore mjaft aktiviste të Gjykatës Supreme të SHBA-ve, e cila fuqishëm përkrahte doktrinën laisser fair kundër politikave shtetërore që synonin të mbronin qytetarin amerikan kundër praktikave abuzuese të punës pa kufij dhe pa mbrojtje në punë).

47 Miguel Schor " An Essay on the Emergence of Constitutional Courts: The Cases of Mexico and Columbia". *Indiana Journal of Global Legal Studies* Volume 16 Issue 1 (Winter 2009) fq. 173-194 në fq. 179.

48 Shih më gjerësisht për këtë rilindje si dhe për vetë historikun e reformës kushtetuese të vitit 1994 në Jorge A. Vargas, "1996 The Rebirth of the Supreme Court of Mexico: An Appraisal of President Zedillo's Judicial Reform of 1995". *Indiana Journal of Global Legal Studies* Vol. 16 Isseu 1 (Winter 2009) fq. 173-194.

49 Me reformën e vitit 1994, GJSDV nga një gjykatë me autorizime kasative në çështjet administrative, civile dhe penale është shndërruar në një gjykatë kushtetuese. Cf. Eduardo Ferrer Mac-Gregor, "La Corte suprema di giustizia del Messico quale tribunale costituzionale." Në Luca Mezzetti (ed.) , *SISTEMI E MODELLI DI GIUSTIZIA COSTITUZIONALE* (CEDAM: Padova, 2009) fq. 587-622 në fq. 588.

50 *Mexico's Constitution of 1917 with Amendments through 2015. Në internet:* https://www.constituteproject.org/ constitution/Mexico_2015.pdf?lang=en (shikuar në qershor 2017).

51 Miguel-Stearns, Teresa M., "Judicial Power in Latin America: a Short Survey", fq.101-102.

Kërkesa në kontestet kushtetuese ka të bëj me konfliktet për kompetencë. Neni 105.1 ["Pushteti Gjyqësor"] i Kushtetutës përcakton 11 kompetenca ekskluzive të **GJSDM** në këtë fushë. Këto kompetenca mund të mblidhen në tri grupe. Në grupin e parë hyjnë konfliktet ndërmjet rendeve të ndryshme juridike që kanë për objekt ligjshmërinë apo kushtetutshmërinë e një norme apo akti të përgjithshëm (ta zëmë, konflikti në mes të federatës dhe një shteti anëtar me distriktin federal, si dhe në mes të federatës dhe shtetit anëtar). Në grupin e dytë hyjnë konfliktet në mes të organeve të rendeve të ndryshme juridike që kanë për objekt ligjshmërinë apo kushtetutshmërinë e normave apo akteve juridike të përgjithshme (ta zëmë, konflikti në mes të pushtetit ekzekutiv qendror dhe **Kongresit të Meksikos**). Në grupin e tretë hyn konflikti në mes të organeve të rendit të njëjtë juridik lidhur me kushtetutshmërinë e normave dhe akteve të përgjithshme (ta zëmë, konflikti në mes të dy pushteteve të një shteti anëtar të federatës, si dhe konflikti në mes të një shteti anëtarë të federatës dhe një komune të shtetit të njëjtë).

Kërkesa **amparo** rregullohet me nenet 103 dhe 107 ["Pushteti Gjyqësor"] të **Kushtetutës së Meksikos.** Ky mekanizëm apo instrument është më i popullarizuari në **Meksikë** dhe ka një traditë shekullore. Nga **Meksika**, më pastaj, gjatë shekullit XX, **amparo** është përhapur në tërë botën. Siç e kemi konstatuar në kapitujt paraprakë, **amparo** ka lindur për herë të parë me **Kushtetutën e Shtetit Jukatan të Meksikës** të vitit 1841. Në nivel federal u fut si institucion i veçantë vetëm më vonë, me amendamentet kushtetuese të vitit 1847. Sot **amparo** ka marrë përmasa globale dhe ka një përhapje të jashtëzakonshme anekënd botës[52].

Si cilësi themelore e vendimeve në gjykimet sipas kërkesës **amparo** është se ofrojnë mbrojtje vetëm për rastin konkret dhe të vetëm. Kjo do të thotë se me vendimet që merren në procedurat sipas kërkesës **amparo**, vjen vetëm deri te moszbatimi i ligjit, i cili përndryshe është dashur të zbatohet në rastin apo mosmarrëveshjen konkrete tanimë të vendosur. Me këtë nënkuptohet se as vendimi i dhënë sipas kërkesës **amparo**, me të cilin një ligj shpallet jo kushtetues, nuk ka mundësi të ketë efekt të përgjithshëm (**erga omnes**).

Që nga vitit 1893 në **Nikaragua** ka pasur një sërë tekstesh kushtetuese me të cilat është njohur kompetenca e **Gjykatës Supreme të Drejtësisë** (**GJSDN**) në lëmin e drejtësisë kushtetuese. Kjo kompetencë është njohur edhe me Kushtetutën e vitit 1987, aktualisht në fuqi[53]. Në nenin 164 ["Pushteti Gjyqësor"] të Kushtetutës listohen pesëmbëdhjetë funksionet e **GJSDN**. Në mesin e tyre janë edhe çështjet që kanë të bëjnë me vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve (pika 4 e nenit) dhe mbrojtjen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë sipas procedurës së iniciuar me **amparo** (pika 3 e nenit).

Në rastin e **Panamasë**, kontrolli i koncentruar (**centralizuar**) i kushtetutshmërisë ka nisur më 1937, jo me kushtetutë, por me ligj. Ky model është zëvendësuar me Kushtetutën e Panamasë të vitit 1941. Sipas këtij modeli, pranë **Gjykatës Supreme të Drejtësisë** (**GJSDP**) mund të ankimoheshin vendimet e gjykatave më të ulëta me qëllim të përfundimit të kontrollit të tyre dhe eventualisht anulimit (prishjes) në rastet kur ishin shqiptuar përmes zbatimit kundërkushtetues të ligjit. Kjo në literaturë ndryshe cilësohet si **ankesë për kasacion kushtetues** sepse ka qenë hallka e fundit në vijë vertikale për të kontrolluar kushtetutshmërinë e vendimit të shkallës më të ulët, përkatësisht për të kontrolluar nëse shkalla e ulët ka zbatuar ligjin në mënyrë kushtetuese. Pra, këtu nuk flitej për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve, por për konstatim nëse zbatimi i tyre ka qenë kushtetues. Që nga Kushtetuta e vitit 1941, kur u ndërpre ky lloj i kontrollit kushtetues[54], e deri më nxjerrjen e Kushtetutës së vitit 1978, aktualisht në fuqi me amendamentet e fundit të vitit 2004[55], zgjidhja panameze përfaqëson një ndër sistemet më të koncentruara (central-

---

52 Cf. Eduardo Ferrer Mac-Gregor, "La Corte suprema di giustizia del Messico quale tribunale costituzionale." fq. 605-608.

53 Constitution of Nicaragua of 1987 with Amendments through 2005. Në internet: https://www.constituteproject. org/constitution/Nicaragua_2005.pdf (shikuar në korrik 2017).

54 Roberta Bille, "La giustizia costituzionale nell'America latina", fq. 497.

55 *Constitution of Panama of 1972 with Amendments through 2004.* Në internet: https://www.constituteproject.org/ constitution/Panama_2004.pdf?lang=en (shikuar në korrik 2017).

izuara) dhe më të gjëra të kontrollit kushtetues që ekzistojnë në të drejtën krahasuese[56]. Kjo shihet qartë nga formulimi i nenit 206 ["Pushteti Gjyqësor"] të Kushtetutës, i cili përcakton në tri pika funksionet në çështjet ligjore dhe në ato kushtetuese të cilat i kryen **GJSDP**. Nga këto tri pika, vetëm pika e parë flet për funksionet kushtetuese të cilat i ushtron kjo gjykatë. Aty thuhet se **GJSDP**:

"[...] 1. Kujdeset për integritetin e Kushtetutës. Për këtë qëllim, pas dëgjimit të mendimit të Prokurorit të Përgjithshëm apo Avokatit të Përgjithshëm, në një seancë plenare Gjykata shqyrton dhe vendos mbi rastet që kanë të bëjnë me jokushtetutshmërinë e ligjeve, dekreteve, vendimeve, aktvendimeve dhe akteve tjera, të cilat, për shkak të formës apo përmbajtjes, janë sfiduar para saj, nga cilido person.

Në rastet kur, gjatë procedimeve gjyqësore të rastit, zyrtari publik i ngarkuar me detyrën e administrimit të drejtësisë konsideron, apo një gjë e tillë vërejtur nga njëra prej palëve, se dispozita ligjore apo dispozita tjetër juridike që duhet të zbatohet, është jokushtetuese, ai/ajo do t'ia parashtrojë për dijeni Gjykatës në një mbledhje plenare rastin e tillë që është në gjykim e sipër, përveç rasteve kur dispozita e tillë veç ka qenë objekti i vendimit, si dhe do të urdhërojë vazhdimin e rastit gjyqësor konkret deri në vendosjen e çështjes së jokushtetutshmërisë.

Palët kanë mundësi që të formulojnë vërejtjet e tilla (që kanë të bëjnë me jokushtetutshmërinë gjatë procedimeve gjyqësore të një rasti: vërejtja jonë) vetëm një herë gjatë kohës sa është duke u gjykuar rasti konkret [...]."

Në **Paragvaj,** ka qenë Kushtetuta e vitit 1967 ajo e cila në nenin 200 ia njohu të drejtën **Gjykatës Supreme të Drejtësisë** (**GJSDPG**) për të vendosur lidhur me kushtetutshmërinë e ligjeve.[57] Kjo e drejtë u konfirmua me nenin 259.5 ["Gjykata Supreme e Drejtësisë: Detyrat dhe Autorizimet"] të Kushtetutës së vitit 1992, e cila aktualisht është në fuqi[58]. Ky nen në këtë pikë në një mënyrë shumë të shkurtër flet për të drejtën e **GJSDPG** "për të marrë në dijeni dhe për të vendosur lidhur me jokushtetutshmërinë".

Urugvaji me Kushtetutën e vitit 1934, për herë të parë ka parashikuar të drejtën e **Gjykatës Supreme të Drejtësisë** (**GJSDU**) për të shpallur si jokushtetues ligjet, si për shkaqe formale ashtu edhe për ato substanciale. Me disa ndryshime, një dispozitë e tillë ende është në fuqi në nenin 256 të Kushtetutës së vitit 1966[59]. Kjo Kushtetutë, megjithatë, ka më shumë nene që merren me kushtetutshmërinë, të cilat në vijim i përflasim.

Nenet 256 – 261 të kapitullit IX të pjesës XV ["Pushteti Gjyqësor"] të Kushtetutës së vitit 1966 flasin në mënyrë të veçantë për kushtetutshmërinë e legjislacionit. Neni 256 shprehimisht thekson se ligjet mund të shpallen si jokushtetuese si për shkak të formës ashtu dhe për shkak të përmbajtjes, në pajtim me dispozitat e neneve tjera që pasojnë, të neneve 257-261. Kështu, neni 257 tregon se **GJSDU** ka juridiksion ekskluziv dhe origjinal për të shqyrtuar dhe vendosur rastet e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe duhet të japë vendimet sipas kushteve që kërkohen për shqiptimin e vendimeve përfundimtare gjyqësore. Neni në vijim, neni 258 flet për palën e autorizuar, e cila mund të kërkojë shpalljen e ligjit si jo kushtetues apo moszbatimin e dispozitave të tij jo kushtetuese. Palët të tilla në këtë vend janë secili person që konsideron

---

56 Roberta Bille, Op, cit . fq. 497.

57 Neni 200 ["Pushteti Gjyqësor: Përbërja dhe Kompetencat"] i Kushtetutës së vitit 1967:
"Gjykata Supreme e Drejtësisë ka pushtetin për t'i shpallur si jokushtetues ligjet që janë në kundërshtim me këtë Kushtetutë, apo të paaplikueshme dispozitat konkrete që duhet të zbatohen në një rast konkret dhe që janë në kundërshtim me Kushtetutën. Vendimi për mosaplikim ka efekt vetëm në rastin konkret në të cilin duhet të zbatohen dispozitat e tilla jo kushtetuese.
Procedurat mund të nisen me një padi paranë Gjykatës Supreme dhe, përjashtimisht, para gjykatës së secilës shkallë, dhe pararendësit e rastit do të dërgohen në Gjykatën Supreme të Drejtësisë. Incidenti nuk pezullon rastin, i cili vazhdon deri në momentin e dhënies së aktgjykimit për rastin konkret". Cf. *Constitution of the Republic of Paraguay of 1967.* Në internet : http://www.ifes.org/ sites / default / files/con00138.pdf(shikuar në korrik 2017).

58 *Constitution of Paraguay of 1992 with Amendments through 2011*. Në internet: https://www.constituteproject. org/constitution/Paraguay_2011.pdf?lang=en (shikuar në korrik 2017).

59 *Constitution of Uruguay of 1966, Reinstated in 1985, with Amendments through 2004*. Në internet: https://www.constituteproject.org/constitution/Uruguay_2004.pdf?lang=en (shikuar në korrik 2017).

se është dëmtuar një interes i tij/saj i drejtpërdrejt, personal dhe legjitim. Në një rast të tillë, sipas pikës një dhe dy të këtij neni, ai/ajo mund të paraqesë një kërkesë të drejtpërdrejtë pranë **GJSDU** (**actio popularis**) apo një kërkesë incidentale pranë çdo gjykate në të cilën është duke u zhvilluar procesi gjyqësor konkret (**kontrolli incidental**). Në paragrafin e fundit të nenin 258 pranohet e drejta e secilës gjykatë pranë të cilës zhvillohet një gjykim konkret të kërkoj me vetiniciativë kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit që duhet të zbatohet në një rast konkret, apo moszbatimin e tij në atë rast, para se të marr vendim lidhur me meritat e rastit konkret. Në një rast të tillë, gjykata e rastit duhet të pezullojë procedurat dhe të referojë çështjen për vendosje lidhur me kushtetutshmërinë e ligjit pranë **GJSDU**. Neni në vijim, neni 259, sqaron efektet e vendimit të dhënë lidhur me jokushtetutshmërinë e ligjit, duke sqaruar se ato efekte janë vetëm inter partes. Me këtë zgjidhje, ky vend ka treguar se respekton vullnetin e sovranit të shprehur përmes legjislativit të vet. Kjo nënkupton se ligji ngelet në fuqi dhe në rastet tjera të ngjashme mund të ketë një vendim tjetër dhe të ndryshëm nga ai i mëparshmi.

Kontrollit të kushtetutshmërisë i nënshtrohen, sipas dispozitës së nenit 260 të Kushtetutës, edhe dekretet qeveritare që kanë fuqi ligjore, sipas kushteve të parashikuara në nenet si më sipër.

Në fund, neni 261 tregon se procedurat pranë **GJSDU** në lidhje me çështjet kushtetuese rregullohen me ligj, i cili është ligj i përgjithshëm që normon anën organizative dhe funksionale të jetës dhe punës së **GJSDU**. Kjo është kështu edhe në vendet tjera, pra çdoherë ka një ligj, i zakonshëm apo organik dhe kushtetues për nga natyra, me të cilin rregullohen kryesisht funksionimi dhe organizimi i punës së organit më të lartë kushtetues që merret me çështje kushtetuese. Shumë rrallë këto ligje caktojnë juridiksion shtesë në dobi të organit kushtetues më të lartë që merret më çështje kushtetuese.

Në **Venezuel**ë, që nga Kushtetuta e vitit 1858 është njohur e drejta e **Gjykatës Supreme të Drejtësisë** (GJSDV) për të vendosur lidhur me **actio popularis** të ngritura nga çdo qytetar dhe eventualisht për të vendosur për shpalljen si jo kushtetues të ligjeve provinciale. Me **Kodin e Procedurës Civile** të vitit 1897, megjithatë, në sistemin juridik venezuelan u fut edhe kontrolli difuz (**decentralizuar**), duke e bërë këtë vend përkohësisht si një vend me model të përzier (**mikst**) të kontrollit të kushtetutshmërisë. Kjo ndryshoi me reformën kushtetuese të vitit 1999. Më këtë reformë, **GJSDV** nuk ekziston më për shkak të themelimit, në vend të saj, të **TSDV**. Në kuadër të këtij organi më të lartë në hierarkinë e gjyqësorit të rregullt në këtë vend, tani ekziston një dhomë e posaçme kushtetuese me kompetencë ekskluzive për të gjykuar lidhur me kushtetutshmërinë e akteve legjislative dhe të akteve tjera të njëjta apo më të ulëta se ligji.

Ani se në nenin 334 (paragrafët 1 & 2) [“Garantimi i Kushtetutës”] të Kushtetutës përcaktohet se çdo gjyqtar ka për detyrë që **ex officio** të mos zbatojë asnjë ligj apo normë tjetër juridike që bie ndesh me Kushtetutën, në neni në vijim, neni 335 i kapitullit të njëjtë, qartë përcakton se **TSDV**, përmes një dhomë speciale, ka kompetencë ekskluzive për të anuluar ligjet jo kushtetuese. Kjo përfshinë edhe çdo normë apo akt juridik të autoriteteve publike që bien ndesh me Kushtetutën dhe që janë nxjerrë me qëllim të implementimit të ligjeve të shpallura si jo kushtetuese.

Neni tjetër, neni 336, po ashtu i kapitullit të njejët, përcakton në mënyrë mjaft të detajuar juridiksionin e dhomës së specializuar kushtetuese . Ky juridiksion përfshin:

“(1) Shpalljen të pavlefshme, në tërësi apo pjesërisht, të ligjeve apo akteve tjera të Asamblesë Nacionale të cilat kanë fuqinë e ligjit dhe bien ndesh me Kushtetutën;

(2) Shpalljen të pavlefshme, në tërësi apo pjesërisht, të kushtetutave dhe ligjeve të shteteve anëtare, rregulloreve komunale dhe akteve tjera të trupave deliberative të shteteve anëtare dhe të komunave të cilat janë nxjerrë në vijim të zbatimit të Kushtetutës dhe janë në konflikt me të njëjtën;

(3) Shpalljen të pavlefshme, në tërësi apo pjesërisht, të akteve të Ekzekutivit Nacional që kanë fuqinë e ligjit, të cilat janë në kundërshtim me këtë Kushtetutë;

(4) Shpalljen të pavlefshme, në tërësi apo pjesërisht, të akteve të nxjerra në vijim të zbatimit të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm të Kushtetutës nga çdo organ qeveritar që ushtron autorizime të pushtetit publik;

(5) Vërtetimin, sipas kërkesës së Presidentit të Republikës apo të Asamblesë Nacionale, të kushtetutshmërisë së traktateve ndërkombëtare të nënshkruara nga Republika, para se të ndodhë ratifikimi i tyre;

(6) Rishikimin në të gjitha rastet, edhe ex officio, të kushtetutshmërisë së dekreteve të Presidentit të Republikës me të cilin shpalljet gjendja e jashtëzakonshme;

(7) Shpalljen e jo kushtetutshmërisë së ometimeve (lëshimeve) në nivel komunal, shtetëror, apo në nivel të legjislaturave, të cilat kanë të bëjnë me ometimet (lëshimet) për ndërmarrjen e masave që garantojnë respektimin e Kushtetutës, ose zbatimin e masave të tilla në mënyrë jo të plotë; si dhe të përcaktojë kufijtë kohorë dhe, kur kjo është e nevojshme, udhëzimet për të korrigjuar mangësitë e ometimeve (lëshimeve) në fjalë;

(8) Zgjedhjen e çdo konflikti ndërmjet dispozitave ligjore dhe përcaktimin se cilat nga to duhet të mbizotërojnë kundrejt njëra tjetrës;

(9) Zgjedhjen e mosmarrëveshjeve kushtetuese që lindin në mes të cilado prej organeve të pushtetit publik;

(10) Rishikimi i aktgjykimeve që mishërojnë urdhra mbrojtës kushtetues apo kontroll lidhur me kushtetutshmërinë e ligjeve apo të rregullave tjera juridike, të cilat janë dhënë nga ana e gjykatave të Republikës, sipas kushteve të përcaktuara me ligjin përkatës organik;

(11) Çdo funksion tjetër i përcaktuar me këtë Kushtetutë dhe me ligj".

Sikundër shihet, në **Venezuelë** nuk përjashtohet goditja e vendimeve individuale të gjykatave si dhe e akteve të tjera administrative, të cilat mund të sfidohen në instancën e fundit përmes procedurave që iniciohen me **amparo** ose me **habeas corpus** në të gjitha format e tyre. Kjo mund të bëhet sipas procedurave ligjore të ligjit organik, **Ligjit për Tribunalin Suprem të Drejtësisë** i datës 19 maj 2004, i cili më tutje ka rregulluar organizimin e brendshëm dhe procedurën pranë **TSDV**, përfshirë procedurat pranë dhomës së veçantë për çështjet kushtetuese.

Nga tërë kjo del se në çështjet kushtetuese, **TSDV** përmes dhomës së vet të specializuar për çështje kushtetuese luan rolin unifikues (**nomofilatik**) në nivel vendi me efekt të një **stare decisis** që ekziston në sistemit amerikan të drejtësisë.

6.3. Modeli i koncentruar (i centralizuar) me gjykatë të ndarë kushtetuese

Ky model mund të jetë i pastër, do të thotë pa asnjë cilësi të sistemit difuz **(decentralizuar**) por edhe të përzier (**mikst**), siç është në **Portugali**, ku, përveç gjykatës kushtetuese edhe gjykatat e rregullta, ruajnë të drejtën e anashkalimit, përkatësisht të drejtën e shpalljes jo kushtetuese (me efekt **inter partes**) të një normë juridike në të cilën gjyqtarët hasin gjatë vendosjes apo zgjidhjes së një rasti apo mosmarrëveshjeje konkrete. Modeli i përzier (mikst) mund të ekzistojë edhe në sistemet e koncentruara (centralizuara) të kontrollit të kushtetutshmërisë që nuk kanë gjykatë të ndarë kushtetuese. Këtë e kemi sqaruar më herët.

Modeli i koncentruar (centralizuar) me gjykatë të ndarë kushtetuese është më i rrallë në vendet e **Amerikës Latine**. Në këtë model, aktualisht bëjnë pjesë këto vende: **Kili, Bolivia, Kolumbia** dhe **Surinam**. Këtu hyn në kuptimin teknik të fjalës edhe provinca argjentinase **Tucman**, e cila ka gjykatë të veçantë kushtetuese. Meqë në këtë libër flasim vetëm për shtetet sovrane dhe të pavarura, **Argjentinën** e kemi trajtuar ndaras në modelin tjetër, kurse provincën në fjalë nuk mund ta trajtojmë tutje sepse është pjesë përbërëse e një shteti tjetër sovran dhe të pavarur.

Modeli i konventruar i kontrollit kushtetues në **Kili** është futur me reformën kushtetuese të fillimit të viteve ’70 të shekullit të kaluar. **Tribunali Kushtetues i Kilit** (**TKK**), i themeluar në këtë kohë, pati një jetë të shkurtër si pasojë e puçit ushtarak të 11 shtatorit 1973. Me Kushtetutën e vitit 1980, u rikrijua sërish. Me reformën kushtetuese të vitit 2005 u eliminua cilësia kryesore e sistemit kushtetues në këtë vend, e cila ka paraqitur çdoherë një veçori karakteristike të gjyqësisë kushtetuese latine-amerikane: sipas Kushtetutës së vitit 1980, në Kili ka ekzistuar kontrolli kushtetues i dyfishtë. Në vijë incidentale, kontrolli kushtetues në këtë kohë, sipas kësaj kushtetute, kryhej nga ana e Gjykatës Supreme[60], me vendime që kishin efekt **inter partes**, kurse në rrugë të drejtpërdrejtë dhe kryesore kontrollin kushtetues me efekte **erga omnes** e kryente Tribunali Kushtetues[61].

Me reformën kushtetuese të vitit 2005, aktualisht në fuqi[62], kjo gjendje ka ndryshuar: aktualisht vetëm **TKK**, asnjëherë Gjykata Supreme, mund të shpallë jo kushtetues një ligj dhe të urdhërojnë moszbatimin e tij përmes rrugës incidentale, përkatësisht përmes kërkesës për kontroll incidental, të cilën në **TKK** e paraqet gjyqtari kompetent i rastit (**iudex a quo**).[63] Në të njëjtën kohë, **TKK** ruan të drejtën e kontrollit kushtetues në vijë kryesore (**prinicipaliter**) dhe të drejtpërdrejtë.[64]

---

60 Kapitulli VI , neni 80 [“Gjyqësori”] i Kushtetutës së vitit 1980: “Gjykata Supreme, përmes një letre zyrtare apo sipas kërkesës së njërës palë, në çështjet për të cilat ka dijeni apo të cilat janë apeluar pranë saj nga një gjykatë, mund të shpallë si jo të zbatueshëm ndaj çështjeve të tilla çdo normë juridike që është në kundërshtim me Kushtetutën. Kjo mund të ndodhë gjatë çdo faze të procedurës gjyqësore, kurse gjykata pranë së cilës zhvillohet çështja, mund të pezullojë procedurat e tilla që janë në vijim e sipër”.

61 Cf. Kapitulli VI, nenet 81-83 [“Gjykata Kushtetuese”] të Kushtetutës së vitit 1980, të cilat flasin për përbërjen e Gjykatës (neni 81, juridiksionin e saj dhe palët e autorizuara (neni 82) dhe për natyrën juridike dhe efektet e vendimeve të gjykatës (neni 83). Në paragrafin e fundit të nenit 83 shprehimisht përcaktohej se Gjykata Supreme më nuk ka mundësi që të mos zbatojë ligjin të cilin Gjykata Kushtetuese e shpall si kushtetues.

62 *Constitution of Chile of 1980 with Amendments through 2012.* Në internet : https:// wwwconstituteproject. org/ constitution/ Chile_2012.pdf (shikuar në korrik 2017).

63 Cf. Kapitulli VIII, neni 93 [“Tribunali Kushtetuese”] i Kushtetutës së vitit 1980, amendamentet e vitit 2005, aktualisht në fuqi. Ky nen normon juridiksionin dhe palët e autorizuara. Në pikën e dytë të paragrafit të parë të nenit në fjalë flitet për juridiksionin e Tribunalit për të vendosur lidhur me çështjet kushtetuese në urdhrat e Gjykatës Supreme, Gjykatës së Apelit dhe të Tribunalit të Zgjedhjeve. Sipas paragrafit të tretë të këtij neni, Tribunali merr në dijeni për çështjet kushtetuese që kanë lindur me rastin e vendimeve të caktuara nga pika e dytë e paragrafit të parë si më sipër sipas kërkesës së Presidentit të Republikës, secila nga Dhomat e Parlamentit, apo nga dhjetë anëtarë të secilës prej dhomave, si dhe nga secili person që është pjesë e një vendimi në vijim e sipër pranë një gjykate të rregullt apo para ndonjë tribunali special dhe që afektohet në ushtrimit e të drejtave e lirive të tij/saj nga ajo çfarë është vendosur me vendim origjinal respketiv (të Gjykatës Supreme, Gjykatës së Apelit, apo Tribunalit të Zgjedhjeve).
Në pikën e gjashtë të paragrafit të parë të nenit 93 si më sipër Kushtetuta përcakton mundësinë e Tribunalit që me një shumicë absolute të të gjithë anëtarëve të vet të vendosur lidhur me jozbatueshmërinë e secilës normë juridike që duhet të zbatohet në ndonjë masë që duhet ët merret nga ana e një gjykate të rregullt apo pranë ndonjë tribunali special, normë e cila rezulton të jetë në kundërshtim me Kushtetutën. Sipas paragrafit 11 të nenit 93 të Kushtetutës, kjo çështje mund të ngrihet nga secila palë apo nga vetë gjykatësi me kompetencë për rastin, **iudex a quo**.
Në vijim të kësaj, në pikën e shtatë të paragrafit të parë të nenit 93 si më sipër, Kushtetuta përcakton mundësinë që me një shumicë prej katër të pestave të krejt anëtarëve të Tribunalit të vendoset lidhur me jokushtetutshmërinë e normës juridike e cila është shpallur si jo e zbatueshme siaps procedurës së parashikuar në pikën paraprake, pra në pikën e gjashtë. Kjo zgjidhje është mjaft interesante dhe ka pasur në natyrën juridike dhe efektet e vendimit të marrë mbi këtë bazë, pra mbi bazën e pikës shtatë të nenit 93 të Kushtetutës. Kjo shihet qartë nga redaktimi i paragrafit të trembëdhjetë të nenit 93 si më sipër: në rast të shpalljes së jo të zbatueshëm të një normë sipas pikës gjashtë të paragrafit të parë, atëherë duhet të ketë një veprim publik me të cilin kërkohet nga Tribunali që të deklarohet lidhur me jokushtetutshmërinë në mënyrë përfundimtare, veprim që mund të ndërmerret edhe nga vet Tribunali **ex officio**. Paragrafi i tretë i nenit 94 qartëson efektin **erga omnes** me efekt **ex nunc** dhe **ablativ** të çdo vendimi të marrë në vijim të zbatimit të pikave 6 dhe 7 të paragrafit të parë të nenit 93 si më sipër. Kjo do të thotë se vendimet e Tribunalit të dhëna sipas këtyre pikave kanë efekte vetëm për të ardhmen (**efekti erga omnes ex tunc**), duke i nxjerrë nga rendi juridik normat që janë shpallur jokushtetuese (**efekti erga omnes ablativ**).

64 Në nenin 93, paragrafi i parë nën pikën 1 dhe 3 flitet për kontrollin preventiv të ligjeve kushtetuese organike, të ligjeve të zakonshme, të amendamenteve kushtetuese dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare, do të thotë për kontrollin preventiv të tyre para se të miratohen në Kongres. Pika 4 në vijim flet për kontrollin e kushtetutshmërisë së dekreteve me fuqi ligjore, kurse pika 9 për kontrollin e kushtetutshmërisë së dekreteve të caktuara të Presidentit të Republikës. Pikat tjera të këtij neni kanë të bëjnë me kontrollin e kushtetutshmërisë së partive politike, të grupeve dhe asociacioneve tjera, për zgjidhjen e konflikteve t[për kompetencë, për konstatimin e përgjegjësisë së anëtarëve të Kongresit, dhe kështu me radhë.

Po ashtu, njëjtë si në vendet ku nuk ka një gjykatë të ndarë kushtetuese, ekziston një ligj i veçantë me të cilin rregullohen çështjet e organizimit, procedurave si dhe punët tjera që kanë të bëjnë me jetën dhe veprimtarinë e **TKK**[65]. Në disa raste, siç kemi parë, ky ligj i veçantë është ligj kushtetues, në rastet tjera ligj organik, e nganjëherë ka dy këto cilësi së bashku, në vartësi të materies që rregullon. Kur ka natyrë të ligjit kushtetues, atëherë zakonisht gjykatës kushtetuese i njihen kompetenca shtesë përveç atyre të përcaktuara me kushtetutë. Kjo mund të ndodhë edhe me ligjin e veçantë organik, por zakonisht me ligj kushtetues përcaktohen kompetencat shtesë të gjykatës së ndarë kushtetuese. Kjo nuk ndodh me rastet e sistemit të kontrollit kushtetues të **koncentruar** (**centralizuar**) pa gjykatë të ndarë kushtetuese. Siç dihet, në këto sisteme, gjykatat kanë një ligj të veçantë që rregullon materjen e pushtetit gjyqësor në përgjithësi ashtu që nuk normojnë kompetenca shtesë për atë pjesë të gjyqësorit që kryen funksione kushtetuese: ato kompetenca kushtetuese përsaktësohen në tekstin kushtetuese në mënyrë taksative dhe nuk lihet hapësirë për ligje të tjera që të caktojnë juridiksion shtesë. Këtë e kemi parë më sipër gjatë trajtimeve tona për sistemin e gjyqësisë kushtetuese të **koncentruar** (**centralizuar**) pa gjykatë të ndarë kushtetuese.

Me Kushtetutën e vitit 1994, në **Bolivi** është kaluar nga kontrolli **difuz** (decentralizuar) në kontrollin e **koncentruar** (centralizuar) të kushtetutshmërisë, pasi që këtë vit u krijua një gjykate e ndarë kushtetuese. Në nenet 119-121 të Kapitullit VIII të Kushtetutës përcaktohej juridiksioni dhe palët e autorizuara, mënyra e zgjedhjes së gjyqtarëve, organizimi dhe përbërja e **Tribunalit Kushtetues të Bolivisë** (TKB), si dhe çështje të tjera lidhur me këtë[66]. Në nenin 116 të dispozitave të përgjithshme ["Pushteti Gjyqësor"] të Kushtetutës së vitit 1994, Tribunali Kushtetues përbënte pjesë të pushtetit gjyqësor në vend. Në nenin 228 ["Epërsia e Kushtetutës"] të Kushtetutës së vitit 1994, urdhëron gjyqtarët dhe të gjithë tjerët për t'i dhënë përparësi zbatimit të Kushtetutës kundrejt çdo ligji apo dispozite tjetër. Kjo sikur lë përshtypjen se fjala ka qenë për një sistem të **përzier** (mikst) të kontrollit kushtetues. Kjo, megjithatë, nuk është kështu: **Ligji nr. 1.836 për Tribunalin Kushtetues të Bolivisë** ia ka njohur **TKB**-së kompetencën ekskluzive për të shpallur jokushtetues ligjet dhe aktet tjera që kanë fuqi të njëjtë me ligjet[67].

Me Kushtetutën e vitit 2009, aktualisht në fuqi, kjo gjendje ka ndryshuar: neni i saj 411 ["Supremacia dhe Reforma e Kushtetutës"] bën fjalë për nënshtrueshmërinë e të gjithave ndaj Kushtetutës, pa autorizuar gjyqtarët në moszbatim të ligjeve apo normave të tjera në rastet kur ato bien ndesh me Kushtetutën. Në këtë nen flitet për hierarkinë e burimeve, por jo edhe për ndonjë autorizim për moszbatim të dispozitave jokushtetuese nga ana e gjyqtarëve, siç përcaktohej më herët me nenin e sipërcekur 228 të Kushtetutës së vitit 1994.

Në pjesën e dytë të Kushtetutës së vitit 2009, flitet për strukturën funksionale dhe organizimin e shtetit, përcaktohet përbërja, roli, natyra, pozita, juridiksioni, palët e autorizuara dhe natyra juridike e vendimeve të institucionit me juridiksion ekskluziv në çështjet kushtetuese. Ky institucion tanimë nuk quhet **Tribunal Kushtetues**, por **Tribunal Kushtetues Plurinacional i Bolivisë** (**TKPB**)[68]. Juridiksioni i tij

---

65 Procedura si dhe kushtet e lejueshmërisë për vënien në lëvizje, përkatësisht për ushtrimin e këtij veprimi publik duhet të përcaktohet me ligj kushtetues organik të veçantë, thuhet në këtë paragrafin e dymbëdhjetë të nenit 93 të Kushtetutës. Një ligj i tillë është nxjerrë në maj të vitit 1981 me ndryshimet e mëvonshme dhe mban numrin Ligji Nr. 17.997. Cf. Roberta Bille, "La giustizia costituzionale nell'America latina", fq. 497.

66 *Constitucion Politica de Bolivia de 1967 con reformas de 1994* . Në internet: http://www.ifes. org/ sites/ default/ files/con00036. pdf (shikuar në korrik 2017).

67 Cf. neni 7 ["Kompetencat dhe Autorizimet"] i Ligjit nr. 1836 për Tribunalin Kushtetute i datës 1 prill 1998. *Ley del Tribunal Constitucional, Ley no. 1836 . 1 de Abril, 1998*. Në internet: https://bolivia.infoleyes. com/ norma/ 00/ley- del-tribunal-constitucional-1836 (shikuar në korrik 2017) . Për komente akademike, Cf. Roberta Bille, "La giustizia costituzionale nell'America latina", fq. 495. Ky ligj është abroguar më datën 6 korrik 2010 ku është nxjerru Ligji për Tribunalin Kushtetues Plurinacional, aktualisht në fuqi. Cf. *Ley del Tribunal Constitucional Plurinacional, Ley no. 027 . 6 de Julio, 2010*. Në internet : https:// bolivia. infoleyes.com/norma/1918/ley-del-tribunal-constitucional-plurinacional-027 (shikuar në korrik 2017).

68 Pjesa II ["Struktura Funksionale dhe Organizimi i Shtetit"], Titulli III ["Organi Gjyqësor dhe Gjykata Kushtetuese Plurinacionale"] . Kapitulli ["Gjykata Kushtetuese Pluri-Nacionale"] e Kushtetutës së Kolumbisë të vitit 2009. Cf. *Constitution of Plurinational State of Bolivia of 2009*. Në internet: https://www.constituteproject. org/ constitution/Bolivia_2009.pdf (shikuar në korrik 2017).

përcaktohet me nenet 196–204 ["Tribunali Kushtetues Plurinacional"] të Kushtetutës, Ligjin për Organin Gjyqësor, Ligjin Nr. 025 të datës 24 qershor 2010,[69] si dhe me Ligjin e sipërcekur nr. 027 për **TKP** të datës 6 korrik 2010.

Në nenin 196.1. të Kushtetutës, **TKPB** definohet si organ që siguron supremacinë (epërsinë) e Kushtetutës, ushtron kontroll kushtetues dhe siguron respektin për të drejtat e liritë themelore dhe vënien e tyre në jetë. Neni 202 në mënyrë shumë të çuditshme flet për juridiksionin e **TKPB**, duke theksuar se "përveç juridiksionit të përcaktuara me ligj", ai ka edhe autorizime të tjera që figurojnë në këtë nen. Këto autorizime kryesisht kanë të bëjnë me kontrollin abstrakt të normave ligjore dhe normave të tjera me karakter të përgjithshëm, konfliktin për kompetencë në mes të organeve shtetërore, kontrollin preventiv të amendamenteve kushtetues dhe marrëveshjeve ndërkombëtare para ratifikimit të tyre e kështu me radhë. Edhe Ligji nr. 025, në nenin e vet 12 që flet për autorizimet e **TKPB**, përsërit të njëjtat autorizime të këtij organi që gjenden në nenin 202 të Kushtetutës. Ajo çfarë bie në sy tani është se në Kushtetutë më nuk ka më dispozita që flasin për kontrollin incidental të kushtetutshmërisë. Nuk ka dispozita të tilla as në Ligjin nr. 025. Kjo do të thotë se **Bolivia** bën pjesë në sistemin e pastër të **koncentruar** (centralizuar) të kontrollit kushtetues. Se kjo është kështu, përveç juridiksionit të qartë të përcaktuar në Kushtetutë dhe me Ligjin nr. 025, shihet edhe nga përcaktimi i natyrës juridike **erga omnes** të vendimeve të **TKPB**: sipas nenit 203 të Kushtetutës, vendimet e tij janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë dhe, si të tilla, asnjëherë nuk mund të apelohen.

Në **Kolumbi**, kompetenca e **Gjykatës Supreme të Drejtësisë** (GJSDKO) në lëmin e kontrollit të kushtetutshmërisë për herë të parë është parashikuar me Kushtetutën e vitit 1886. Vetëm me një ligj të vitit 1910, megjithatë, **GJSDKO**-së iu njoh e drejta e garantimit të supremacisë së Kushtetutës, e cila u bë e mundur përmes ushtrimit të **actio popularis** nga ana e secilit qytetar në këtë vend. Më pastaj, me reformën kushtetuese të vitit 1968, u bë një hap përpara në këtë vend, kur u krijua nja dhomë e veçantë kushtetuese brenda **GJSDKO**, por e cila në çështjet kushtetuese kishte vetëm autorizime konsultative të natyrës jo juridiksinonale. Autorizime të kësaj natyre, pra autorizime të qarta kushtetuese në lëmin e garantimit të supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës dhe të kontrollit të kushtetutshmërisë u parashikuan më 1991: reforma kushtetuese e këtij vitit solli në jetë **Gjykatën Kushtetuese të Kolumbisë** (**GJKKO**), e cila e ka zënë vendin e **GJSDKO-së** në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe sigurimin e supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës dhe kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe të akteve e veprimeve tjera[70]. Megjithatë, vlen të theksohet se **GJKKO** nuk ka kompetencë për të zgjidhur çështjet kushtetuese, të cilat lindin në kuadër të kontesteve administrative. Kjo kompetencë, sipas nenit 237 .2 ["Juridiksioni në Kontestet Administrative] të Kushtetutës, i takon **Këshillit të Shtetit.**

Statusi dhe juridiksioni i **GJKKO** përcaktohen në titullin VIII ["Pushteti Gjyqësor"] të Kushtetutës. Në kuadër të këtij titulli, megjithatë, juridiksioni kushtetues figuron si i ndarë: nenet 239 – 245 ["Juridiksioni Kushtetues"] i Kushtetutës janë të veçanta dhe vijnë pas atyre që flasin për juridiksionin e përgjithshëm dhe atë administrativ, kurse para juridiksioneve speciale, të cilat mund të ekzistojnë për popujt autoktonë dhe për disa çështje tjera të parashikuara në nenet 246-248 ["Juridiksionet Speciale"] të Kushtetutës.

Sipas nenit 241.1 të Kushtetutës, **GJKKO** ka për detyrë primare sigurimin e supremacisë (epërsisë) dhe integritetit të Kushtetutës vetëm në kuadër të kushteve të parapara më paragrafin në vijim të këtij neni. Për të arritur këtë qëllim, pra sigurimin e integritetit dhe të supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës, **GJKKO**, sipas nenit 241.2 të Kushtetutës, ka tri lloje të kompetencave juridiksionale dhe një administrative:

- kontrolli abstrakt i kushtetutshmërisë së normave juridike, në të cilin përfshihen: kontrolli preventiv i anës procedurale të kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese, i akteve juridike lidhur me organizimin e referendumeve, plebishiteve apo konsultimeve popullore, pastaj, kontrolli preventiv

[69] Cf. Nenet 4. II ["Ushtrimi i Funksionit Gjyqësor"] i Ligjit, *Ley del Organo Judicial, Ley 025. 24 de Junio, 2010*. Në internet: https://bolivia.infoleyes.com/norma/1839/ ley-del-organo-judicial-025 (shikuar në korrik 2017).

[70] *Constitution of Columbia of 1991 with Amendments through 2005.* Në internet : https://www.constituteproject. org/ constitution/Colombia_2005.pdf. (shikuar së fundi në qershor 2017).

dhe represiv i kushtetutshmërisë së ligjeve (si në aspektin procedural ashtu dhe në atë përmbajtjesore), i dekreteve me fuqi ligjore (të qeverisë dhe të presidentit) dhe, së fundi, kontrollin preventiv të marrëveshjeve ndërkombëtare para ratifikimit të tyre;
- kontrolli i kushtetutshmërisë së vendimet gjyqësore të lidhura me mbrojtjen e të drejtave kushtetuese;
- vendosja lidhur me të aq. përjashtim;[71] dhe, së fundi,
- kompetenca administrative për të draftuar aktet e brendshme normative[72].

Ish-kolonia e **Holandës**, vendi i vogël në verilindje të Amerikës Latine, **Surinam,** i takon vendeve të këtij kontinenti që kanë sistem të **koncentruar** (centralizuar) të gjyqësisë kushtetuese me gjykatë të ndarë kushtetuese. Në fakt, ky është rasti i fundit që diskutojmë në këtë seksion të këtij libri**. Gjykata Kushtetuese e Surinam-it** (GJKSU) ekziston vetëm si projekt kushtetues, pra sipas kushtetutës në fuqi[73], por asnjëherë nuk është formuar deri në momentin që po shkruajmë këtë libër[74].

Statusi, roli dhe juridiksioni i **GJKSU** rregullohen vetëm me një nen të Kushtetutës, nenin 144 ["Gjykata Kushtetuese"]. Për të flitet në kuadër të seksionit të katër të kapitullit XV ["Sistemi Juridik"] të Kushtetutës. Në paragrafin e parë të këtij neni thuhet se do të formohet një gjykatë kushtetuese si një trup i pavarur i përbërë nga presidenti, zëvendëspresidenti dhe tre anëtarë dhe tre zëvendës anëtarë. Këta zgjidhen nga Kuvendi Nacional, për një mandat pesëvjeçar.

Në kuadrin e detyrave të **GJKSU**, sipas paragrafit të dytë të nenit të vetëm si më sipër, bëjnë pjesë:

- vlerësimi i kushtetutshmërisë së akteve juridike dhe marrëveshjeve ndërkombëtare ; dhe
- vlerësimi e kushtetutshmërisë së vendimeve të institucioneve qeveritare sa i përket të drejtave dhe lirive të garantuara me kapitullin e pestë të Kushtetutës,

Në paragrafin e tretë flitet për efektet **erga omnes** të vendimeve të **GJKSU**. Aty thuhet në mënyrë shumë të qartë se në rast të konstatimit të mospajtueshmërisë me Kushtetutën të një apo disa dispozitave të aktit juridik, të marrëveshjes ndërkombëtare apo të vendimeve të institucioneve qeveritare, atëherë të njëjtat nuk do të konsiderohen të detyrueshme për askënd. Pika e fundit, paragrafi i katërt, flet për rregullat dhe aktet e brendshme normative të cilat përcaktojnë përbërjen, organizimin dhe procedurat pranë **GJKSU**, të cilat duhet të jenë të autorizuara me një ligj të veçantë. Sikundër u tha, akoma nuk ka një ligj të tillë dhe akoma nuk ka një gjykatë kushtetuese operacionale në këtë vend.

6.4. Sistemet tjera të kontrollit kushtetues

Në sistemet tjera të kontrollit të kushtetutshmërisë bëjnë pjesë **Kuba**, si një rast shumë i veçantë, si dhe vendet e **Indeve Perëndimore Britanike**, pra ish-kolonitë britanike **Barbados**, **Gujana (**Guyana**)**, **Xhamaika** (Jamiaca) dhe **Trinidad & Tobago**.

Sipas **Kushtetutës së Kubës** të datës 24 shkurt 1976[75], aktualisht në fuqi, kontrolli i kushtetutshmërisë është politik dhe kryhet nga **Kuvendi Kombëtar**. Kjo përcaktohet qartë në nenin 75 ["Organet Supreme

---

71 Ky nen rregullon dhënien e dëshmive para organit legjislativ venezuelan dhe mundësinë që qytetarët të lirohen nga ky detyrim, por vetëm me vendim të Gjykatës Kushtetues. Ky vendim, sipas këtij neni, merret pas dëgjimit të palëve dhe në afat prej dhjetë (10) ditësh.

72 Sikundër shihet nga ky formulim, Gjykata i nxjerr aktet e veta normative me të cilat rregullohet organizimi i brendshëm dhe puna e saj. Kjo nënkupton se në rastin e Kolumbisë nuk ka një ligj për Gjykatën Kushtetuese, me te cilin eventualisht od të precizohej apo shtohej juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese, siç është rasti me disa vende tjera të cilat janë diskutuar në këtë libër. Cf. Po ashtu Roberta Bille, "La giustizia costituzionale nell'America latina", fq. 493.

73 Constitution of Suriname of 1987 with Amendments through 1992. Në internet: https://www.constituteproject. org/constitution/Surinam_1992.pdf?lang=en (shikuar në korrik 2017) .

74 *FREEDOM HOUSE. REPORTS: SURINAME. 2017.* Në internet: https://freedomhouse.org/report/freedom-press/2014/suriname (shikuar në korrik 2017).

75 Constitution of Cuba of 1976 with Amendments through 2002. Në internet : https://www.constituteproject. org/ constitution/Cuba_2002.pdf?lang=en (shikuar në korrik 2017).

të Pushtetit Shtetëror"] të Kushtetutës. Pikat nën "b", "c" dhe "ch" të këtij neni flasin për kompetencat e Kuvendit sikur të ishte fjala për një juridiksion të ndarë kushtetuese: pika nën "b" i njeh Kuvendit të drejtën e anulimit të ligjeve; pika nën "c" shprehimisht thotë se Kuvendi vendos mbi kushtetutshmërinë e ligjeve, dekreteve me fuqi të ligjit, dekreteve dhe normave tjera të përgjithshme; kurse pika nën "ch" i jep të drejtën organit në fjalë për të revokuar në tërësi apo pjesërisht dekretet me fuqi ligjore te Qeverisë. Këto autorizime për kontroll politik kushtetues janë tërësisht në natyrën e një sistemi socialist kushtetues ku mbizotëron legaliteti socialist i bazuar në supremacinë (epërsinë) e plotë të Kuvendit dhe unitetin e pushtetit komunist me Partinë Komuniste si avangardë[76]. Në një sistem të tillë kushtetues çdo bisedë serioze për kontroll të kushtetutshmërisë të bazuar në premisat teorike dhe përvojat e civilizimit juridik-kushtetues perëndimor të proveniencës liberale është një iluzion. Ka një kohë që disa autorë flasin për restaurimin e kontrollit kushtetues në Kubë, gjë për të cilën kemi folur në kapitullin e mëhershëm (kap. 3), ashtu siç ekzistuar në këtë sipas kushtetutave të viteve 1910 dhe 1940. Kjo sepse, siç thonë këta autorë, një gjë e tillë i nevojitet **Kubës** për t'u pajtuar me SHBA-të, për të dalë nga izolimi dhe për të rimarrë vendin e vet në botën perëndimore, të cilës gjeografikisht i takon.[77]

Ish kolonitë britanike, **Indet Perëndimore Britanike**, nuk kanë përqafuar sistemin juridik dhe kushtetues britanik pas pavarësimit të tyre. Ky sistem, siç dihet nga diskutimet tona të mëhershme, nuk ka një institucion të veçantë që ushtron kontroll kushtetues. Në vendet e sipërcekura, dikur ish-koloni britanike, të cilat u pavarësuan në vitet '60 të shekullit XX, kontrolli kushtetues ushtrohet nga ana e organit më të lartë kushtetues me juridiksion gjyqësor në lëmin përkatës administrativ, civil dhe penal.

Për dallim nga sistemi amë, shumica e ish-kolonive të **Indeve Perëndimore Britanike** kanë përqafuar sistemin **difuz** (decentralizuar) të kontrollit kushtetues. Ky sistem pak a shumë ndjek trendet e përgjithshme që zhvillohen gjetiu nëpër vendet tjera. Në këtë sistem, megjithatë, gjykata supreme si instanca më e lartë gjyqësore në nivel vendi e ka fjalën e fundit kur bëhet fjalë për unifikimin e praktikës gjyqësore në çështjet kushtetuese. Në këtë libër nuk diskutojmë të gjitha ish-kolonitë britanike në Amerikën Latine, si p.sh. **Belize**, por vetëm ato të **Indeve Perëndimore**.

Në parim, në këto vende kontrolli kushtetues është futur si reagim ndaj vënies në jetë të parimit të ndarjes së pushteteve me qëllim të pengimit të uzurpimit të pushtetit gjyqësor nga ana e legjislativit. Para se të shohim si duket kjo në kushtetutat e këtyre vendeve, duhet të theksojmë se në pikëpamje të modelit të adaptuar të kontrollit të kushtetutshmërisë, këto vende ndahen në dy grupe: në disa prej tyre, të gjitha gjykatat e rregullta në mënyrë shprehimore autorizohen për të ushtruar kontroll kushtetues, kurse në disa tjera ky autorizim i takon vetëm gjykatës supreme. Në vendet e fundit hyn, ta zëmë, **Trinidad dhe Tobago**. Në këtë vend, vetëm Gjykata Supreme është e autorizuar në mënyrë shprehimore për të kryer interpretimin e Kushtetutës: seksionet 13 ["Aktet në Shpërputhje me Seksionet 4 dhe 5"] dhe 14 ["Zbatimi i Dispozitave Mbrojtëse"] lidhur me seksionin 99 ["Gjykata Supreme"] të **Kushtetutës së Trinidad dhe Tobago** të vitit 1976, aktualisht në fuqi, në mënyrë shprehimore sanksionojnë një mundësi të tillë.[78] Kjo për faktin se seksioni 2 i dispozitave themelore të Kushtetutës flet për pavlefshmërinë e çdo ligji apo norme tjetër juridike që nuk është në pajtim me te.

---

[76] Cf. Nenet 3, 5- 6, 7, 10 ["Themelet Politike, Shoqëror dhe Ekonomike të Shteteit"] dhe nenet 69-70 dhe 75 ["Organet Supreme të Pushtetit Popullor"] të Kushteutës së Kubës të vitit 1976.

[77] Michael B. Wise, "Cuba and Judicial Review". *Southwestern Journal of Law and Trade in the the Americas* Vol. 7 No. 2 (2000) fq. 247-266 (ku autori diskuton rikthimin e traditës kubaneze të kontrollit kushtetues që ka ekzistuar në gjysmën e parë të shekullit '20-të, daljen nga izolimi dhe pajtimin me SHBA-në dhe demokratizimin e vendit si arsye për rifutjen e kontrollit kushtetues në Kubë).

[78] *The Constitution of the Republic of Trinidad and Tobago of 1976*. Në internet : http://www.oas. org/ juridico/ english/mesic-ic3_tto_constitution.pdf (shikuar në korrik 2017). Këto dispozita të Kushtetutës që flasin për kontrollin gjyqësor të kushtetutshmërisë në këtë vend duhen shikuar në dritën e dispozitave të ligjit për kontrollin Gjyqësor të vitit 2000, të cilat më tutje specifikojnë procedurat e kontrollit gjyqësor të legjislacionit dhe bazat për të kërkuar kontroll gjyqësor të tij. Cf. *Judicial Review Act. Act 60 of 2000*. Në internet : http://rgd.legalaffairs.gov.tt/ laws2/ alphabetical _list/ lawspdfs/7.08.pdf (shikuar në korrik 2017).

Barbados, ish-kolonia britanike që fitoi pavarësinë më 1966, është një monarki kushtetuese me demokraci parlamentare që modelohet sipas shembullit të **Westminster**-it. Në çështjet e kontrollit gjyqësor, gjërat nuk qëndrojnë më ndryshe se me vendin pararendës: me **Kushtetutën e Barbados**-it të vitit 1966, aktualisht në fuqi[79], njëjtë si në rastin e **Trinidad dhe Tobago**, njihet supremacia (epërsia) e Kushtetutës, jo e parlamentit[80]. Të gjitha gjykatat janë të autorizuara për të kryer kontrollin gjyqësor të kushtetutshmërisë në mënyrë difuze (të dekoncentruar), por vetëm Gjykata Supreme ka fjalën e fundit në çështjet kushtetuese. Në këtë vend, Kushtetuta ka edhe dispozita që flasin për **Gjykatën e Drejtësisë së Karaibeve** (GJDKA), e cila ka juridiksion preliminar në çështjet e kontrollit të pajtueshmërisë me Marrëveshjen e vitit 2002 për krijimin e **GJDKA** të dispozitave të brendshme të vendeve anëtare. Zgjidhje të ngjashme kushtetuese ka edhe **Gujana (**Guyana). Këto dy vende, sikundër edhe **Trinidad dhe Tobago**, ia kanë njohur fjalën e fundit **GJDKA**, në vend se **Këshillit të Lartë** (**Privy Council**), në çështjet e interpretimit të normave të marrëveshjes së vitit 2002 si më sipër.[81] **Kushtetuta e Xhamaika-s** (Jamiaca) e vitit 1962 në tërësi gati ka modelin e **Trinidad dhe Tobago** dhe të **Barbados** sa i përket kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë[82].

6.5. Komente dhe pyetje

6.5.1. Në ndjekje të rrugës së revolucioneve amerikane të vitit 1776 dhe franceze të vitit 1789, konstitucionalizmi latino-amerikan fillimisht ka rrëshqitur në kulturën jakobine, përkatësisht në vazhdimin e njohjen se supremacisë (epërsisë) absolute të pushtetit legjislativ si një organ sovran me fjalën e fundit. Diskutoni!

6.5.2. Gjykimi i kushtetutshmërisë përmes rrugës gjyqësore, sipas modelit të **SHBA**-ve, në **Amerikën Latine** ka nisur vetëm në gjysmën e dytë të shekullit XIX. Si moment kyç i kthesës nga sistemi politik i kontrollit kushtetues në kontrollin kushtetues juridiksional që ushtrohet nga një mekanizëm gjyqësor merret viti 1841, kur është nxjerrë **Kushtetuta e Shtetit Jukatan të Meksikos**. Diskutoni!

6.5.3. Doktrina **stare decisis** lidhet me evoluimin e sistemit të së drejtës së përgjithshme (**common law**) dhe nuk ka qenë rezultat i përcaktimeve të tekstit të shkruar kushtetues. Për pasojë, doktrina e tillë është e huaj për sistemin civil (**kontinental**) të së drejtës, në të cilin teksti kushtetues qartë përcakton nëse vendimet gjyqësore në çështjet kushtetuese do të kenë efekt **inter partes** apo **erga omnes**, apo dyja efektet në vartësi të natyrës së vendimit dhe mënyrës së marrjes (votimit) të tij.

Kjo aspak nuk lidhet me atë nëse një vend ka apo jo një gjykatë të ndarë kushtetuese: me rëndësi është nëse organi që vendos ka ose jo juridiksion të qartë dhe të ndarë në çështjet kushtetuese. Kjo shihet më së miri në rastin e vendeve të **Amerikës Latine** dhe zgjidhjet kushtetuese të përqafuara atje. Pas demokratizimit, të filluar në mesin e viteve ’80 të shekullit të kaluar, kushtetutat nacionale të këtyre vendeve zëvendësuan dispozitat mbi efektet **inter partes** të vendimeve gjyqësore në çështjet kushtetuese me dispozita të qarta mbi efektin **erga omnes** të vendimeve në fjalë. Kjo bëri të mundur që të krijohet kontrolli gjyqësor i kushtetutshmërisë, në kuptimin real të këtij fjalëkuptimi që ai përfaqëson në

---

79 *The Constitution of Barbados, 1966 (as amended up to 2007).* Në internet: http://www.wipo.int/ wipolex/ en/ details.jsp?id=7386 (shikuar në korrik 2017).

80 Seksioni 1 [“Kapitulli I: Kushtetuta”] i Kushtetutës: “Kjo Kushtetutë është ligj suprem i Barbadosit dhe, në pajtim me dispzoitat supreme të kësja Kushteute, nëse ndonjë ligj tjetër nuk është na pajtim me te, kjo Kushtetutë do të prevalojë dhe çdo ligj tjetër, në mësa që nuk është në pajtim me te, do të konsiderohet i pavlefshëm.”

81 Kapitulli XI [“Gjyqësia”] i Kushtetutës së Guajanës të vitit 1980. Në këtë kapitull përdoren shprehjet e njejta me një stipulim mjaft të ngjashëm me dy vendet e sipërcekura. Cf. *CONSTITUTION OF THE CO-OPERATIVE REPUBLIC OF GUYANA . ACT 1980*. Në internet : http:// www.wipo.int/ edocs/ lexdocs/ laws/ en/ gy/gy009en.pdf (shikuar në korrik 2017).

82 Krahaso dispozitat e seksionit 2 të dispozitave themelore lidhur me dispozitat e seksioneve 97-103 të kapitullit VII [“Gjyqësia”] , Pjesa e Parë [“Gjykata Supreme”] të Kushtetutë së Xhamajka-s të vitit 1962 . Seksioni 2 qartë flet për supremacinë (epërsinë) e Kushtetutës ndaj çdo ligji tjetër dhe, për pasojë, autorizon çdo gjykatë që të sigurojë supremacinë (epërsinë) e Kushtetutës, kurse në çështjet kushtetuese në nivel nacional, Gjykata Supreme e ka rolin unifikues (nomofilatik) të praktikës gjqyësore . Cf. *JAMAICA (CONSTITUTION) ORDER IN COUNCIL. 1962* . Në internet: http://www.constitutionnet.org/sit9999es/default/files/jamaica_constitution_1962_0.pdf (shikuar në korrik 2017).

konstitucionalizmin bashkëkohor perëndimor. Në këtë kuptim, vendet e Amerikës Latine, **grosso modo**, në literaturë grupohen ne tri grupe. Diskutoni!

6.5.4. Në modelin e pastër difuz (**decentralizuar**) asnjëherë nuk mund të ushtrohet kontrolli abstrakt i kushtetutshmërisë, siç është rasti me **SHBA**. Në sistemin e koncentruar (**centralizuar**) apo në atë të përzier (**mikst**), një gjë e tillë nuk përjashtohet. Kjo, megjithatë, nuk është ndarja e seksioneve që kemi ndjekur në këtë kapitull, por përcaktimet kushtetuese të vendeve të **Amerikës Latine** dhe vetë dizajnin e tyre institucional të përcaktuar me kushtetutat nacionale. Çfarë do të thotë kjo?

6.5.5. Përqafimi i modelit të kontrollit difuz (**decentralizuar**) të gjyqësisë kushtetuese nënkupton se secili gjyqtar, pavarësisht nga shkalla e gjyqësorit ku vepron, mund të ushtrojë vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve tjera normative. Në këtë model është detyrim i çdo gjyqtari për të gjykuar mbi pajtueshmërinë me kushtetutën të secilit ligj apo akt juridik tjetër normativ i cili duhet të zbatohet me rastin e zgjidhjes apo vendosjes së një rasti apo mosmarrëveshjeje konkrete. Në rastin kur **iudex a quo** (gjyqtari i rastit) gjen se ligji apo akti tjetër normativ nuk është në pajtim me ligjin, atëherë ai nuk i zbaton ato në rastin apo mosmarrëveshjen konkrete që gjendet para tij. Kjo është cilësia bazike, e cila e dallon këtë model nga tjerët. Në mesin e vendeve të këtij kontinenti që i pari ka përqafuar **modelin difuz** (të decentralizuar) është **Argjenitina.** Diskutoni!

6.5.6. Sikundër u tha më sipër, cilësia bazike e modelit difuz (**decentralizuar**) të kontrollit kushtetues është se secili gjyqtar ka për detyrë që të mos zbatoj asnjë ligj apo akt normativ që bie ndesh me kushtetutën gjatë kohës sa është duke zgjedhur apo vendosur një rast apo mosmarrëveshje. Në kuadër të **modelit difuz** (**decentralizuar**) janë zhvilluar edhe disa cilësi të tjera të rëndësishme, të cilat këtë model e bëjnë të dallueshëm nga modelet tjera të kontrollit kushtetues. Këto cilësi zbatohen dhe vlejnë ndaj të gjitha vendeve që përqafojnë **modelin difuz** (**decentralizuar**). Me çfarë kanë të bëjnë këto cilësi?

6.5.7. Përveç **amparo**, në vendet e **Amerikës Latine** janë krijuar edhe institute tjera që kanë për qëllim zbutjen e efekteve negative të cilat lindin si pasojë e mosekzistimit të rregullës **stare decisis** në këto vende. Për çfarë bëhet fjalë këtu? Si e kryen këtë funksion **amparo** dhe si instituti tjetër, të cilin ju duhet ta identifikoni?

6.5.8. Ekziston një model i gjyqësisë kushtetuese, në të cilin kontrolli kushtetues ushtrohet nga një organ, i cili, në hierarkinë e gjyqësorit, zë pozitën më të lartë dhe në gjirin e vet ka një dhomë (departament, trup) të posaçme. Kjo dhomë (departament, trup), sipas kushtetutës nacionale ka të drejtën ekskluzive për të ushtruar kontrollin e kushtetutshmërisë dhe për të thënë fjalën e fundit në çdo çështje kushtetuese. Si quhet ky model? Diskutoni për këtë model dhe vendet që e përqafojnë.

6.5.9. Veçori e sistemit të koncentruar, me apo pa gjykatë të ndarë kushtetuese, është se gjyqtari dhe gjykata kompetente janë të veshur **me autorizime ablative**. Çfarë do të thotë kjo?

6.5.10. Natyra juridike e forcës detyruese të precedentëve, në rendin kushtetues brazilian ka filluar në mesin e viteve ’60 të shekullit të kaluar, kurse është bërë standard me nenin 103 a të Kushtetutës së amendamentuar në vitin 2004. Këto precedente të detyrueshme njihen me emrin kushtetues **sumula.** Çfarë janë këto dhe me çfarë kanë të bëjnë?

6.5.11. Në **El Salvador** ka pasur një ngritje progresive të kontrollit të koncentruar (**centralizuar**) të kushtetutshmërisë, me fillim që nga Kushtetuta e El Savadorit e vitit 1950. Me këtë Kushtetutë, **GJSDE** iu njoh e drejta për të vendosur lidhur me jokushtetutshmërinë e normave juridike. Kjo procedurë mund të vihej në lëvizje me **actio popularis**. Me Kushtetutën e vitit 1983, megjithatë, u bë progres i dukshëm dhe i qartë në lëmin e kontrollit të koncentruar (**centralizuar**) të kushtetutshmërisë në këtë vend. Diskutoni!

6.5.12. Nga dispozitat e nenit në vijim, nenit 185 i Kushtetutës së Hundurasit, aktualisht në fuqi, më së miri shihet natyra juridike dhe efektet e **actio popularis** në këtë vend, si dhe vetë esenca e kontrollit të koncentruar (**centralizuar**) të kushtetutshmërisë. Në paragrafin e parë të këtij neni përcaktohet se, çdo-

kush që konsideron se është i dëmtuar në interesat e vetë të drejtpërdrejtë, personal dhe legjitim, mund të parashtroj **actio popularis**, në pajtim me pikat 1 deri 3 të këtij paragrafi. Tregoni ndaj kujt dhe nga kush mund të ushtrohet **actio popularis** në këtë vend?

6.5.13. Në **Kosta Rika**, përqafimi i modelit të **kontrollit të koncentruar** (**centralizuar**) të gjyqësisë kushtetuese ka kaluar nëpër disa faza. Diskuto!

6.5.14. Me reformat e vitit 1994, gjykata më e lartë në Meksikë, **GJSDV** ka pësuar një rilindje në lëmin e gjyqësisë kushtetuese, duke fituar autorizime të kontrollit të drejtpërdrejtë dhe të koncentruar (**centralizuar**) të kushtetutshmërisë. Diskuto si ka qenë gjendja para këtij viti dhe si është ajo tani!

6.5.15. Kërkesa **amparo** rregullohet me nenet 103 dhe 107 ["Pushteti Gjyqësor"] të **Kushtetutës së Meksikos.** Ky mekanizëm apo instrument është më i popullarizuari në **Meksikë** dhe ka një traditë shekullore. Nga **Meksika**, më pastaj, gjatë shekullit XX, **amparo** është përhapur në tërë botën. Për herë të parë në këtë vend **amparo** ka lindur me **Kushtetutën e Shtetit Jukatan të Meksikës** të vitit 1841. Diskutoni cilat janë cilësitë themelore të këtij instituti dhe mekanizmi!

6.5.16. Në **Venezuelë** nuk përjashtohet goditja e vendimeve individuale të gjykatave si dhe e akteve të tjera administrative. Ato mund të sfidohen në instancën e fundit përmes procedurave që iniciohen me **amparo** ose me kërkesën **habeas corpus**, në të gjitha format e tyre. Kjo mund të bëhet sipas procedurave ligjore të ligjit organik, **Ligjit për Tribunalin Suprem të Drejtësisë,** datë 19 maj 2004, i cili më tutje ka rregulluar organizimin e brendshëm dhe procedurën pranë **TSDV**, përfshirë procedurat pranë dhomës së veçantë për çështjet kushtetuese. Diskutoni!

6.5.17. Modeli i koncentruar (centralizuar) me gjykatë të ndarë kushtetuese është më i rrallë në vendet e **Amerikës Latine**. Në këtë model, aktualisht bëjnë pjesë këto vende: **Kili, Bolivia, Kolumbia** dhe **Surinam**. Këtu hyn në kuptimin teknik të fjalës edhe provinca argjentinase **Tucman**, e cila ka gjykatë të veçantë kushtetuese. Diskutoni rastet e këtyre katër vendeve të Amerikës Latine që kanë gjykata të ndara kushtetuese! Provoni të gjeni arsyet pse këto dallojnë nga vendet tjera që kanë qoftë sistem difuz (**decentralizuar**) ose sistem të koncentruar (**centralizuar**) të gjyqësisë kushtetuese, por pa pasur një gjykatë të ndarë kushtetuese!

6.5.18. Përveç juridiksionit të qartë të përcaktuar në Kushtetutë dhe me Ligjin nr. 025, në Bolivi ekziston një përcaktim kushtetues sipas të cilit vendim e **TKPB** kanë natyrë juridike **erga omnes**. A do të thotë kjo se Bolivia bën pjesë në vendet me sistem të koncentruar të kontrollit kushtetues?

6.5.19. Sipas nenit 241.1 të Kushtetutës, **GJKKO** ka për detyrë primare sigurimin e supremacisë (epërsisë) dhe integritetit të Kushtetutës vetëm në kuadër të kushteve të parapara më paragrafin në vijim të këtij neni. Për të arritur këtë qëllim, pra sigurimin e integritetit dhe të supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës, **GJKKO**, sipas nenit 241.2 të Kushtetutës, ka tri lloje të kompetencave juridiksionale dhe një administrative. Cilat janë ato?

6.5.20. Në Surinam, **GJKSU**, e cila asnjëherë nuk është bërë funksionale, sipas Kushtetutës ka disa autorizime kushtetuese që janë tipike për një sistem të centralizuar të kontrollit kushtetues me gjykatë të ndarë kushtetuese. Cilat janë ato?

6.5.21. Sipas **Kushtëtutës së Kubës** të datës 24 shkurt 1976, aktualisht në fuqi, kontrolli i kushtetutshmërisë është politik dhe kryhet nga **Kuvendi Kombëtar**. Pse?

6.5.22. Në vendet e **Indeve Perëndimore Britanike**, kontrolli kushtetues është futur si reagim ndaj vënies në jetë të parimit të ndarjes së pushteteve me qëllim të pengimit të uzurpimit të pushtetit gjyqësor nga ana e legjislativit. Tregoni si duket kjo në disa prej ish-kolonive të kësaj pjese të botës!

6.6. Lexim shtesë

- Arne Marcic, *The Constitutional Review*. Second Edition (Vendeplas Publishing , LLC: USA, 2011-2013)
- Eduardo Rozo Acuria e Paola Maffei, *LE COSTITUZIONI DELL'AMERICA LATINA. I PAESI DELLA COMUNITA ANDINA* (G. GIAPPICHIELLI EDITORE : Torino, 2006)
- Sergio Diaz Ricci, "La giustizia costituzionale nelle Province dell'Argentina". Në Luca Mezzetti, *SISTEMI E MODELLI DI GIUSTIZIA COSTITUZIONALE* (CEDAM : Padova, 2011)
- Ruben Hernandez Valle, "La giustizia costituzionale in Costa Rica". Në Luca Mezzetti, *SISTEMI E MODELLI DI GIUSTIZIA COSTITUZIONALE* (CEDAM : Padova, 2011)
- Stephen Zamora, " Judicial Review in Latin America" . *Southwestern Journal of Law and Trade in the Americas* Vol. 7 No. 2 (2000)
- Dale Beck Furnish, "Judicial Review in Mexico". *Southwestern Journal of Law and Trade in the Americas* Vol. 7 No. 2 (2000)
- Robert S. Barker, "Judicial Review in Costa Rica: Evolution and recent Developments". *Southwestern Journal of Law and Trade in the Americas* Vol. 7 No. 2 (2000)
- Keith S. Rosen, "Judicial review in Brasil: Develop,ments Under the 1988 Constitution". *Southwestern Journal of Law and Trade in the Americas* Vol. 7 No. 2 (2000).

7. SISTEMET (IV): VENDET ISLAMIKE

Përgjithësisht. - Në këto vende ka specifika të shumta, të cilat dalin si pasojë e zbatimit nga ana e tyre të burimeve fetare të së drejtës, kryesisht të asaj që njihet si e **Drejta e Sheriatit**. Në këtë kuadër, si burim primar del libri themelor i myslimanëve, **Kurani**, por edhe burimet tjera të së **Drejtës së Sheriatit**, në vartësi të rregullimit shtetëror, stofit kulturor dhe fetar të shtetit, si dhe në vartësi të shkollës fetare mbi të cilën bazohet regjimi i caktuar në një vend mysliman. Ajo çfarë është e përbashkët në të shumtën e këtyre vendeve, konsiston në faktin se gjyqësia kushtetuese, e çfarëdo modeli qoftë, ka për detyrë primare të sigurojë jo supremacinë (epërsinë) e kushtetutës, por pajtueshmërinë e saj me të drejtën e sheriatit, në rend të parë me **Kuranin** si librin themelor dhe burimin primar dhe kyç të kësaj të drejte.

Modalitetet e sigurimit të supremacisë (epërsisë) së **Kuranit** dhe burimeve të tjera të së **Drejtës së Sheriatit**, në sistemet kushtetuese të vendeve islamike janë të ndryshme, siç janë edhe zgjidhjet institucionale. Ka disa prej tyre që kanë gjykatë të ndarë kushtetuese, të modeluar në formë sipas sistemit **evropian/kelsenian**, por edhe vende të atilla që kultivojnë gjyqësi kushtetuese brenda gjykatës më të lartë në vend, e cila, krahas juridiksionit të përgjithshëm të rregullt ushtron edhe kontrollin e kushtetutshmërisë. E përbashkëta e të gjitha këtyre vendeve që diskutojmë këtu, është se **Kurani** ka një ndikim të madh në zhvillimin e konstitucionalizmit të tyre, i cili, në thelb, ngelet konstitucionalizëm islamik me një formë institucionale që i ngjason institucioneve të gjyqësisë kushtetuese të vendeve të proveniencës së demokracive liberale perëndimore.

Në literaturë ka një përpjekje për të neglizhuar **Islamin,** dhe **Kuranin** si burim i tij themelor, si burim parësor i legjitimitetit të regjimeve politike në vendet islamike. E vërteta e saktë, megjithatë, është se **Islami**, dhe **Kurani** si burim themelor i tij, ka qenë legjitimuesi kryesor i jetës politike-kushtetuese dhe përcaktuesi i zgjidhjeve institucionale në kuadër të të cilave zhvillohet gjyqësia kushtetuese në ato vende.[1] Kultura e mbështetjes në dokumente kushtetuese në vendet islamike, në parim, ka qenë shumë e dobët historikisht shikuar: kuadri kushtetues në kuptimin liberal perëndimor shumë pak ka ndikuar në frenimin e pushtetit dhe bërjen e tij më të përgjegjshëm dhe më llogaridhënës kundrejt shtetasve të këtyre vendeve. Infrastruktura kushtetuese e ligjore në këto vende ka shërbyer, në shumicën e kohës dhe në të shumtën e rasteve, si një bazë për forcimin e sundimit të tyre, gjithnjë duke u bazuar në legjitimitetin dhe supremacinë (epërsinë) kuranore kundrejt çdo teksti tjetër të shkruar nga dora e njeriut[2]. Kjo është esenca e konstitucionalizmit islamik. Me disa nuanca, i njëjtë është në të gjitha vendet islamike. Këtë e diskutojmë në seksionet në vijim.

Në këtë kuptim duhet shikuar "konstitucionalizmi" në vendet islamike, përkatësisht si diçka ku dizajni kushtetues dhe mekanizmat e parashikuar me këtë dizajn për të vënë në jetë tekstin kushtetues nxjerrin legjitimitetin e tyre nga **burime metafizike kuranore** dhe nga burime të tjera të së drejtës së islamike (në vartësi se për cilin version të **Islamit** bëhet fjalë). E njëjta vlen edhe për kontrollin e kushtetutshmërisë dhe modalitetet e tij. Ky kontroll, në vendet islamike ka për cilësi të përbashkët angazhimin e gjykatave

---

1 Abdullahi An-Na'im, *African Constitutionalism and the Role of Islam* (University of Pennsylvania Press: Philadelphia: 2000) fq. 100.

2 Lidhur me këtë, shih më shumë në librin e shkëlqyer të Nathan J. Brown, *Constitutions in a Nonconstitutional World* (State University of New York Press: New York: 2002) (ku autori diskuton dhe shtjellon historikun e zhvillimit të konstitucionalizmit islamik, debatet për dhe kundër rolit të Islamit në këtë zhvillim, gjendjen aktuale të këtij konstitucionalizmi, origjinën dhe gjendjen aktuale të kontrollit të kushtetutshmërisë, atij gjyqësor dhe politik, sikundër dhe modelin e ndjekur në vendet islamike sa i parket kontrollit në fjalë).

që ushtrojnë një kontroll të tillë në dialog me legjislaturën nacionale, gjithnjë me qëllim të kontrollit të kushtetutshmërisë së legjislacionit që ka për pikë referimi jo kushtetutën, por **Kuranin** dhe burimet tjera primare të së **Drejtës së Sheriatit**[3]. Ushtrimi i pushtetit dhe kufizimi i tij, pozita e individit në shoqëri, rregullativa kushtetuese makro dhe mikro sa i përket aspekteve socio-ekonomike dhe socio-politike asnjëherë nuk kanë përmbajtje të pavarur nga burimet kuranore dhe burimet tjera primare të së drejtës islamike (në vartësi se për cilin lloj të **Islamit** bëhet fjalë).

U mor vesh, ka përjashtime nga kjo rregull, siç është rasti me **Tunisinë,** ku **Komisioni i Venecias** ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për hartimin e një kushtetute mjaft demokratike për rrethanat e botës arabe islamike,[4] apo me **Turqinë** në të cilën akoma, në aspektin formal, ekziston një kushtetutë laike që nga vitit 1982 dhe që konsiderohet si akti suprem i organizimit dhe ushtrimit të pushtetit në këtë vend dhe një gjykatë kushtetuese, ani se regjimi aktual e ka zhveshur nga juridiksioni klasik **evropian/kelsenian**. Edhe **Kuvajti** bën pjesë në grupin e vendeve të rralla islamike ku ekziston një kuvend përfaqësues dhe një sistem i kontrollit të kushtetutshmërisë së veprimit politik, ani se në një formë mjaft të dobët.

Këtu flasim gjithnjë për krahasim e këtyre vendeve ndërmjet veti, jo për krahasimin e tyre me vendet e demokracive liberale perëndimore dhe konstitucionalizmin modern perëndimor. Konstitucionalizmi në vendet islamike është ndryshe: ai nuk bazohet në vlerat perëndimore liberale. Për dallim nga konstitucionalizmi perëndimor liberal, ai islamik është i shkurorëzuar nga demokracia e kuptuar si sundim i shumicës. Kjo duhet të jetë baza e të kuptuarit të konstitucionalizmit islamik dhe nënkupton se, për dallim nga konstitucionalizmi perëndimor, konstitucionalizmi islamik ka rrënjë elitike të legjitimimit hyjnor metafizik të pushtetit dhe nuk bazohet në vullnetin e shumicës. Modalitetet e kontrollit të pushtetit politik nuk janë krijuar me qëllim të sigurimit të një roli dinjitoz të individit dhe të lirisë së tij në shoqëri[5].

Kurani dhe besimi **Islam**, ky i fundit në cilindo version të tij, paraqiten si burime të së drejtës, përkatësisht si pika referimi (të drejtpërdrejta apo të tërthorta) për organizimin e jetës dhe për qeverisje në shumicën e vendeve islamike. Rregullat dhe parimet kuranore si dhe rregullat tjera në **Islam**, në cilindo version të kësaj feje, kanë natyrë historike dhe paramoderne. Këto, në vendet islamike, megjithatë, shihen dhe trajtohen si rregulla dhe parime transendente që mund të vlejnë edhe sot si në kohën kur kanë lindur në **Mesjetë**. Si të tilla, këto rregulla dhe parime janë futur në sistemin modern kushtetues të vendeve islamike, pa llogaritur nëse këto rregulla dhe këto parime kanë ndonjë kuptim në33 botën që jetojmë, përkatësisht pa llogaritur nëse kuadri normativ islamik mund të vihet në jetën e njeriut modern pa shkaktuar prodhimin e formave të shfytyruara juridiko-kushtetuese nga ato që ekzistojnë në vendet perëndimore. Duke përqafuar **Kuranin** dhe burimet tjera si pikë kryesore referimi, në veçanti në sferën e të drejtave të njeriut, këto vende operojnë me koncepte dhe praktika të botës paramoderne, botë në të cilën ka pasur diskriminim fetar, gjuhësor, pabarazi sociale dhe politike, dhunë dhe pushtet të pakufizuar dhe autokratik të sundimtarëve. Qasja që bazohet në vlerën transendente të normave dhe parimeve të **Sheriatit,** në të gjitha versionet e tij, e bën të huaj implementimin e konstitucionalizmit bashkëkohor liberal perëndimor në vendet që përqafojnë një qasje të tillë: në një kuadër të tillë normativ juridiko-kushtetues, demokracia, ndarja dhe kufizimi i pushteteve, sundimi i ligjit, respektimi i të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve janë kuptime tërësisht të parëndësishme[6].

---

3 Noah Feldman, *The Fall and Rise of the Islamic State* (Princeton University Press: Princeton, New Jersy, 2008) fq. 120-124.

4 Paul Craig, "Transnational Constitution-Making: The Contribution of the Venice Commission on Law and Democracy". *UC Irvine Journal of International, Transnational, and Comparative Law* Vol. 2 (2017) fq. 57-86 në fq. 73-74, 84; Francesco Duranti, "Constitution of Tunisia, Venice Commission and International Constitutionalism", kapitulli i 5-të i librit të Loretta Dell'Aguzzo and Emidio Diodato (es.), *The 'state' of pivot states in south-eastern Mediterranean: Turkey, Egypt, Israel, and Tunisia after the Arab Spring* (Perugia Stranieri University Press: Perugia, 2016), në fq. 123; Rafaâ Ben Achour, "La Constitution tunisienne du 27 janvier 2014." *Revue française de droit constitutionnel* Vol. 4 No. 100 (2014) fq. 783-801 në. fq. 801.

5 Cf. Nathan J. Brown, *Constitutions in a Nonconstitutional World. Arab Basiç Laws and Prosepcts for Accountable Government*, fq. 105-110.

6 Për këtë, përkatësisht për aspektet teorike-praktike të kufizimeve të **Sheriatit Islam** dhe burimeve të tij në ndërtimin dhe promovimin e konstitucionalizmit sipas koncepteve moderne, shih më shumë në Anver M. Emon, "The Limits of Constitutionalism in the Muslim World: History and Identity in Islamic Law". Në Sujit Choudhry (ed.), *Constitutional Design for Divided Societies: Integration or Accommodation*? (Oxford University Press: Oxford, 2008) fq. 259 – 286.

Në këtë kapitull, jo vetëm për qëllimet e identifikimit, por edhe për arsye pragmatike, ne diskutojmë disa nga vendet e **Gadishullit Arabik** dhe përtej (në drejtim të **Magrebit)**, të cilat kanë qenë nën ndikimin kolonial britanik dhe francez. Këtë ndarje pragmatike në përzgjedhje të vendeve që diskutohen këtu e kemi bërë nisur nga fakti se këto dy fuqi koloniale, **Britania** dhe **Franca**, kanë pasur një ndikim të caktuar në zhvillimin e kulturës juridiko-kushtetuese dhe shtetërore të këtyre vendeve. Ky ndikim kryesisht reflektohet në formë dhe në përzgjedhjen e institucioneve dhe metodave të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së tekstit kushtetues, aty ku ka organe dhe mekanizma të tillë, gjë që në kontekstin islamik nënkupton, në parim, nënshtrimin e këtj teksti ndaj **Kuranit** dhe burimeve tjera primare të së drejtës së **Sheriatit.**[7]

Në vendet islamike, siç do të shihet në vijim, vetëm zgjidhja institucionale, dizajni dhe mekanizmi mund të ngjasojnë me tiparet e konstitucionalizmit liberal modern (ekzistimi i gjykatave, gjykatave të ndara kushtetuese, këshillave kushtetuese etj.). Kjo vjen si rezultat i ndikimit të ish fuqive koloniale në kolonitë e tyre me rastin e pavarësimit.[8]

Në përmbajtje, ndërkaq, gjërat ndryshojnë: në kuptim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së kushtetutës, kufizimit të pushtetit, sigurimit të një pozite të dinjitetshme të individit dhe të pakicave në shoqëri, konstitucionalizmi islamik paraqitet më i pakuptueshëm për një perëndimor. Vendet islamike janë treguar të paafta për të nxjerr nga **Kurani** dhe e drejta e **Sheriatit** parimet e kufizimit të pushtetit të bazuar në një kompakt social të quajtur kushtetutë, sigurimin e supremacisë (epërsisë) së saj ndaj formave të tjera të së drejtës fetare, si dhe për të ofruar një pozitë të dinjitetshme kushtetuese për individin dhe pakicat. Kjo është kështu për shkak se **Kurani** dhe **Sheriati** pashmangshëm i kundërvihen parimit të sovranitetit të kushtetutës dhe ligjit të krijuar nga njeriu si rezultat i sovranitetit të popullit[9]. Në vendet që bazojnë konstitucionalizmin e tyre në këto dy shtylla, legjitimiteti politik është hyjnor, jo civil dhe popullor. Kjo nënkupton se kuadri juridik për veprim duhet të jetë **Kurani** dhe **Sheriati**, jo kushtetuta e ligji të bërë nga dora e njeriut në vijim të zbatimit të vullnetit të zgjedhësve. Këtu si parametër matës i kushtetutshmërisë, me fjalë të tjera, nuk paraqitet kushtetua nacionale, por **Kurani** dhe **Sheriati Islam**. Para se të shohim si duket kjo sipas vendeve që kemi përzgjedhur, ish-kolonitë britanike dhe franceze, t'i themi edhe disa fjalë rreth përzgjedhjes dhe përse kemi bërë këtë përzgjedhje të vendeve islamike.

Në këtë kapitull nuk diskutojmë për **Turqinë** dhe vendet e **Azisë Qendrore**, për **Indonezinë** dhe **Malajzinë** si vendet të fuqishme islamike, sikundër që nuk diskutojmë as për vendet tjera islamike të **Lindjes**

---

7 Në literaturën shkencore dhe në hulumtimet e bëra është konstatuar se në shumicën e rasteve kushtetutat e vendeve islamike e identifikojnë **Sheriatin** ose si burim themelor të legjislacionit ose si një burim primar të krejt të drejtës nacionale: nga njëzet e dy vendet që definojnë **Islamin** si religjion zyrtar, tetëmbëdhjetë prej tyre kanë përcaktuar një rol të madh kushtetues për **Islamin** dhe praktikën gjyqësore të bazuar në te. Këto klauzola kushtetuese që identifikojnë **Sheriatin,** qoftë si burim themelor të legjislacionit apo si një burim primar të krejt të drejtës nacionale gjenden edhe në vendet që nuk kanë përqafuar **Islamin** si religjion zyrtar, siç është rasti, ta zëmë, me **Komoret, Gambinë, Sudanin, Sirinë.** Në disa vende, tekstet me karakter kushtetues normojnë fushat specifike nga e drejta statusore (të drejtat dhe detyrat e burrave dhe grave në martesë, shkurorëzim, trashëgimi, kujdesin e fëmijëve etj. Disa kushtetuta përmbajnë klauzola kushtetuese, të cilat garantojnë barazinë e gjinive deri në masën që kjo barazi është në pajtim me praktikën islamike. I tillë është rasti, ta zëmë, me kushtetutat e **Egjiptit** (më 1971, e hequr më 2012 dhe e rikthyer më 2014 sërish), **Bahrejnit**, **Jemenit, Arabisë Saudite** dhe **Iranit**. Cf. Nathan J. Brown and Mara Revkin, "Islamic Law and Constitutions". Në Anver M. Emon and Rumee Ahmed (ed.) *The Oxford Handbook of Islamic Law* (Online Publication Date: Nov 2015 DOI: 10.1093/ oxfordhb /97801996 79010. 013.27), fq. 1-33 në fq. 3.

8 Në të shumtën e rasteve, vendet islamike kanë përqafuar modelin me gjykatë të ndarë kushtetuese; në disa raste ka pasur përqafim të sistemit të këshillave kushtetuese (ta zëmë, **Algjeria**), kurse një pjesë e vendeve islamike fare nuk i kanë lënë gjyqësorit apo ndonjë mekanizmi tjetër ekuivalent që të luajë ndonjë rol në çështjet e kontrollit kushtetues të pushtetit politik (ta zëmë**, Arabia Saudite**, **Omani**, **Katari** etj.). Përveç kësaj, edhe kur ka një mekanizëm apo institucion formal kushtetues që ushtron kontroll kushtetues të pushtetit politik, vetë pushteti ndërhyn përmes kufizimit të juridiksionit të këtyre institucioneve apo mekanizmave kushtetues në lëmin e kontrollit kushtetues, si dhe përmes kontrollit të mënyrës s zgjedhjes s gjyqtareve apo anëtareve të tjerë të tyre. Si faktor tjetër kufizues, përkatësisht si faktori kyç dhe vendimtar në këtë kufizim në vendet islamike është përcaktimi në shumicën e këtyre vendeve të **Islamit** si ideologji dominonte dhe definimi i **Kuranit** dhe burimeve të tjera primare të **Islamit** si primar dhe përcaktues të rregullave të lojës politike, si dhe të pozitës së individit në shoqëri, të vetë jetës dhe punës së secilit segment socio-politik, kulturor dhe ekonomik. Cf. më shumë për këtë në Nathan J. Brown, "Judicial Review and the Arab World". *Journal of Democracy* Vol. 9 No. Issue 4 (1998). fq. 85-94, në fq. 89-93.

9 Mark Gould, "Islam, the Law, and the Sovereignty of God". *Policy Review* Issue 149 (June–July 2008) fq. 3- 17 në. fq. 3 & 16.

së Largët. Kjo sepse gjatë tërë kohës së ekzistimit të tyre, në kuptim të zhvillimit të konstitucionalizmit modern, këto vende kanë pasur një orientim të fuqishëm perëndimor. Devijimet nga ky trend i përgjithshëm në disa prej tyre, siç është rasti me **Turqinë** e **Rexhep Taip Erdogan**-it, janë kalimtare dhe nuk ndryshojnë shumë në orientimet afatgjate të këtyre vendeve.

Vendet si më sipër diskutohen në kapitullin në vijim pikërisht për arsye se si të tilla kanë specifika konceptuale, institucionale dhe ideologjike që i dallojnë nga vendet e këtij kapitulli. Në kapitullin në vijim do të shihet se ky kategorizim i yni ka një bazë racionale metodologjike, sepse i ofron lexuesit një pasqyrim më real dhe lehtë të kuptueshëm të gjendjes së konstitucionalizmit në vendet islamike, duke bërë dallim në mes të atyre që kanë përzgjedhur një rend kushtetues ku **Kurani** shërben si pikë kryesore e referimit lidhur supremacinë e çdo norme juridike dhe kushtetuese në nivel nacional dhe atyre që në aspektin formal kanë një sistem kushtetues ku kushtetuta konsiderohet si norma supreme (më e larta) në nivel nacional, ani se **de facto** ndikimi i islamit mund të jetë i madh. Veç këtyre, në kapitullin e tetë flasim edhe për vendet tjera, siç është **Izraeli,** për shkak të afërsisë së tij gjeografike me vendet islamike dhe faktit se pikë e referimit tonë është gjeografia dhe modeli perëndimor i konstitucionalizmit i përqafuar në vendet aziatike të përzgjedhura për diskutim ne kapitullin e tetë. **Kina**, e cila në kapitullin tetë diskutohet krahas **Japonisë**, është përzgjedhur me qëllim që lexuesi ynë ta shoh modelin komunist të gjyqësisë kushtetuese në këtë pjesë të botës, njëjtë siç vepruam me **Kubën**, të cilën e trajtuam në kuadër të vendeve të **Amerikës Latine** dhe **Karaibeve,** ku gjendet si një vend i izoluar komunist. E kemi përzgjedhur **Kinën** për të parë se sa dhe si dallon ky vend nga tjerët përreth tij në çështjet e gjyqësisë kushtetuese (u mor vesh, përveç **Koresë së Veriut**, e cila as nuk vlen të merret në diskutim si pasojë e absurditetit të regjimit të saj politik dhe kushtetues). Njëjtë vepruam edhe me vendet e **Magrebit**, **Algjerinë, Marokun** dhe **Tunizinë**. Këto vende i veçuam për lexuesin dhe i trajtuam në këtë kapitull në mënyrë që të shihet dallimi në mes të vendeve islamike që kryesisht i takojnë botës arabe, mirëpo të cilat dukshëm dallojnë nga vendet e Gadishullit Arabik në të cilat Kurani paraqitet si burim primar i sovranitetit dhe i legjislacionit pozitiv. Një përzgjedhje si kjo e jona, në të cilën randomizimi në përzgjedhjen e vendeve që diskutohen kombinohet me kritere tjera konceptuale dhe gjeografike, ideologjike dhe institucionale bën që lexuesi të dijë më shumë për gjyqësorinë kushtetuese në nivel global dhe, të të njëjtën kohë, kjo dije i shërben si metodologji hulumtimi për këtë fushë në të ardhmen.

7.1. Arabia Saudite dhe Egjipti

Arabia Saudite është vendi më teokratik i versionit **Suni të Islamit**. Kjo është kështu sepse, për dallim nga Irani, Arabia ka një regjim monarkik dhe një qeverisje tërësisht jodemokratike, e cila fare nuk bazohet në testimin e vullnetit të votuesve, qoftë edhe në ndonjë prej formave fiktive të testimit. Në këtë vend ekzistojnë një tufë ligjesh themelore, tri sosh, të integruara në një tekst të vetëm. Vetëm në aspektin formal ato ligje mund të cilësohen si kushtetutë. Regjimi në **Riad**, ndërkaq, i cilëson si të tilla. Ato nuk janë, në asnjë pikëpamje dhe mënyrë, kufizues të pushtetit, por vetëm si udhëzues për qëllime informimi të qytetarëve dhe ambientit të jashtëm lidhur me atë se kush është kush në pushtetin politik në këtë vend. Përveç kësaj, Arabia Saudite nuk ka asnjë organ përfaqësues dhe as ndonjë mekanizëm për kontroll të pushtetit monarkik absolut, ani se regjimi cilësohet si monarki kushtetuese. Të shohim nga afër si duket kjo.

I pari nga tri ligjet si më sipër quhet **Ligji Themelor për Qeverisje**, i dyti quhet **Ligji mbi Këshillin Shura**, kurse i treti **Ligji i Provincave**. Të gjitha këto janë nxjerrë në periudhën ndërmjet viteve 1992-2005.[10]

[10] *Constitution of Saudi Arabia of 1992 with Amendments through 2005*. Në internet https://www. Constitu teproj ect. org/constitution/Saudi_Arabia_2005.pdf (shikuar në korrik 2017).
Kërkesat për reformë të cilat ekzistojnë në këtë vend qe një kohë mjaft të gjatë kanë detyruar sundimtarët e familjes **Saud** për të shpallur **Ligjin Themelor** të vitit 1992, në fakt tri ligjet që rregullojnë sferat bazike në këtë vend. Kjo ka ndodhur më 1992. Ky Ligj Themelor sot cilësohet si kushtetutë e këtij vendi në aspektin formal, vetëm sepse është shkruar në një letër, jo pse ka ndonjë vlerë kushtetuese në kuptim të konstitucionalizmit modern. Ai nuk përcakton asnjë kufizim në qeverisje dhe as nuk krijon ndonjë sistem të vërtetë të ndarjes së pushteteve dhe mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve. Në fakt, të drejtat e qytetarëve nuk kanë asnjë relevancë nëse shikohen standardet ndërkombëtare, nisur nga fakti se neni 26 ["Të Drejtat dhe Detyrimet"] i Ligjit Themelor përcakton qartë se "[...] Shteti i mbron të drejtat e njeriut në pajtim me Sheriatin Islam".

Me përjashtim të Kuvajtit, vendet e **Gadishullit Arabik** me rregullim shtetëror mbretëror kanë ngjashmëri të madhe sa i përket formës dhe përmbajtjes së "konstitucionalizmit" që kultivojnë. **Arabia Saudite, Emiratet e Bashkuara Arabe, Omani, Baherini** dhe **Katari** kanë cilësi të njëjta kushtetuese, ani se ka variacione në tekstet kushtetuese të këtyre vendeve. **Arabaia Saudi**te dhe **Omani** janë të fundit në këtë pjesë të botës arabe që kanë nxjerrë tekstet që kanë natyrë dhe rëndësi kushtetuese. Të gjitha dokumentet kushtetuese në këto vende parashikojnë pasjen e asambleve, të cilat nuk janë të zgjedhura dhe kanë rol të rreptë këshillëdhënës për mbretin.

Dokumentet si më sipër me peshë kushtetuese, në këto vende nuk kufizojnë pushtetin e mbretit në ndonjë mënyrë institucionale. Në fakt, më shumë përshkruajnë pushtetin e mbretit sesa bëjnë ndonjë përpjekje për ta kufizuar atë pushtet. Në këtë mënyrë, tekstet që kanë natyrë kushtetuese nëpër këto vende nuk janë vetëm kundërkushtetuese, por, si të tilla, ato as që mund të cilësohen si kushtetuta në kuptimin modern të kësaj fjale, përkatësisht ashtu siç kuptohet kjo në botën liberale të proveniencës perëndimore[11]. Këtu ne fokusohemi vetëm në Arabinë Saudite, kurse vendet e gjirit i zumë në gojë për qëllime krahasimi të afërsisë së tyre. Ta shohim nga afër si duket kjo në rastin e **Arabinë Saudite**, gjithnjë duke iu referuar tri ligjeve të sipërcekura që kanë rëndësi dhe natyrë kushtetuese

Sipas nenit 7 ["Sistemi i Qeverisjes"] të **Ligjit Themelor për Qeverisje** thuhet: "Regjimi nxjerr pushtetin e vet nga **Kurani i Shenjtë** dhe nga **Thëniet dhe Veprat e Profetit,** të cilat mbizotërojnë ndaj këtij ligji dhe ndaj çdo ligj tjetër të Shtetit". Kjo dispozitë e bën të qartë pamundësinë e pasjes së ndonjë kontrolli kushtetues në kuptimin modern të kësaj fjale, përkatësisht tregon se në këtë vend pushteti derivon nga forcat metafizike. Kjo nënkupton se në këtë vend mund të ketë vetëm një "konstitucionalizëm" që fare nuk ka të bëjë me sigurimin e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës, kontrollin e pushtetit apo me mbrojtjen e lirive dhe të drejtave individuale.

Në rastin e **Arabisë Saudite**, për dallim nga **Irani**, kjo mungesë e idesë supremnacinë (epërsinë) e kushtetutës shprehet edhe më ashpër ngaqë fare nuk ekziston një organ përfaqësues, qoftë ai i natyrës konsultative, por që votohet nga populli.[12] Jo vetëm kaq! **Arabia Saudite**, krahas **Katarit** dhe **Omanit**, bën pjesë në vendet arabe që fare nuk i lejojnë gjyqësorit ndonjë ndikim apo rol në kontrollin e veprimeve të pushtetit politik, jo vetëm në sferën e kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve (të cilat ligje, fare nuk ekzistojnë pasi që normat e përgjithshme juridike burojnë nga vullneti metafizik i mbretit saudit, vullnet i cili buron nga **Kurani** dhe **Thëniet dhe Veprat e Profetit**).[13] Fuqia ligjvënëse e mbretit, thënë ndryshe, është e pakufizuar.

Kjo rrethanë, pra mospasja e një trupi përfaqësues në këtë vend, si dhe mungesa e rolit të gjyqësorit për kontrollin e veprimit politik të organeve shtetërore, përfshirë këtu rolin e gjyqësorit në kontrollin kushtetues të ligjeve, bëhet edhe më e qartë nëse kihet parasysh roli kushtetues, pozita dhe juridiksioni i **Këshillit Shura,** një praktikë e nisur me **Kuranin** dhe që ka pasur një ndikim të madh në kulturën dhe historinë arabe. T'i shohim një nga një organet "kushtetuese", përfshirë **Këshillin Shura**, si dhe mënyrën e ndërveprimit në mes të tyre, me mbretin si burim themelor i të gjitha pushteteve në vend.[14]

Në kuptim të konstitucionalizmit në kuadër të botës islamike, krahas vendeve të tjera të gjirit të cekura më lart, Arabia Saudite mban një pozicion fundamentalist. Kjo është kështu për shkak se **Kurani,**

---

[11] Për të gjitha vendet tjera të gjirit arabik, ngjashmëritë e theksuara midis tyre në qasjen jodemokratike ndaj pushtetit dhe kodifikimin e pushtetit absolut të mbretit, me përjashtim të **Kuvajtit**, shih më shumë në: Nathan J. Brown, *Constitutions in a Nonconstitutional World. Arab Basic Laws and Prosepcts for Accountable Government*, fq.54-66

[12] Chibli Mallat, "On the Specificity of Middle Eastern Constitutionalism" *Case Western Reserve Journal of International Law* Vol. 38 Issue 1 (2006) fq. 13-57 në fq.. 34–35.

[13] Nathan J. Brown, "Judicial Review and the Arab World", fq. 85-94, në fq. 89-93.

[14] Shih me kujdes fjalinë e fundit të nenit 44.2 ["Pushtetet e Shtetit"] të **Ligjit Themelor**: "[...] Mbreti është burimi i fundit i të gjitha pushteteve shtetërore".

Thëniet dhe Veprat e Profetit Muhamet janë kushtetutë e këtij vendi[15] dhe implementohen nga gjyqet e **Sheriatit** me **ulema-**të (gjyqtarët fetar), si gjyqtarë dhe këshilltarë legalë në të njëjtën kohë.[16] Shef i shtetit është mbreti, i cili zgjidhet nga familja e madhe **Saud**[17]. Mbreti kryen punët e Shtetit i ndihmuar nga këshilli i ministrave, por edhe mbikëqyr institucionet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësorin sepse është burim i fundit i të gjitha pushteteve.[18] Në **Arabi Saudite**, sikundër u tha, nuk ka dhomë të përfaqësuesve apo parlament, të zgjedhur nga populli. Nuk ka as parti politike.

Se fjala është për një vend që përqafon zgjidhje islamike fundamentale shihet që nga neni 1 ["Parimet e Përgjithshme] lidhur me nenin 44 ["Pushtetet e Shtetit"] të Ligjit Themelor.

Neni 1 përcakton se "Mbretëria e Arabisë Saudite është një vend sovran islamik arab me Islamin si fe të saj. Kurani i Shenjtë dhe Thëniet dhe Veprat e Profetit janë kushtetuta e saj. Gjuha është arabe, kryeqyteti është në Riad", kurse në nenin 44 më tutje operacionalizohet kuptimi i këtij neni. Aty sqarohet se pushtetet e Shtetit përbëhen nga pushteti gjyqësor, pushteti ekzekutiv dhe pushteti organizativ, të cilat bashkëpunojnë në kryerjen e detyrave të tyre, në pajtim me këtë dhe me ligjet tjera.

Jo vetëm në këto dy nene definuese të **Ligjit Themelor**, por edhe gjetiu në dispozitat tjera të tij vërehet zgjidhja fondamentale islamike e sundimit dhe qeverisjes. Të tilla janë dispozitat që kanë të bëjnë me organin që do të duhej të ishte organ përfaqësues i popullit. Ai quhet **Këshilli i Shuras**. Fizionomia e tij përcaktohet me menin 68 ["Pushtetet e Shtetit] të **Ligjit Themelor**: Këshilli formohet dhe shpërbëhet nga mbreti dhe sipas dëshirës së tij vepron e punon. Në literaturë pohohet se ky organ mund të transformohet në një organ përfaqësues, gjë që duket pak e besueshme për shkak se kjo do të paraqiste transformim të vetë natyrës së **Arabisë Saudite** si shtet, nga një monarki absolute në monarki kushtetuese.[19]

Sipas nenit 3 të **Ligjit mbi Këshillin Shura** (**Majlis Al-Shoura**), një ligj ky i ngjashëm me ligjin organik në kuptimin evropian të kësaj fjale, Këshilli përbëhet nga kryetari dhe njëqind e pesëdhjetë anëtarë, të gjithë të emëruar nga mbreti, të cilët kanë autorizim për t'i dhënë këshilla qeverisë në çështjet e interesit publik. Kjo do të thotë se Këshilli ka për qëllim mbrojtjen e interesit publik dhe të jetë zëri i këtij interesi. Ky institut, përndryshe kuranor, ka qenë i vetmi që ka shërbyer si një lloj dere e vogël, përmes të cilës disa vende islamike, përfshirë Arabinë Saudite, kanë arritur që t'i shmangen **Sheriat Islam**, duke u thirrur në interesin publik si bazë për ecjen përpara dhe nxjerrjen e ligjeve moderne me qëllim të adresimit të problemeve dhe halleve të kohës moderne.[20]

Si shembull tjetër i konstitucionalizmit me bazë **Sheriatin** në versionin fundamentalist Suni është pozita e gjyqësorit në këtë vend: gjykatat në tërësi i nënshtrohen mbretit si pushtet ekzekutiv,

---

15 Shih paragrafin e tretë të nenit të parë ["Parimet e Përgjithshme"] lidhur me nenin 7 ["Sistemi i Qeverisjes"] të **Ligjit Themelor**.

16 Neni 48 ["Pushtetet e Shtetit"] i **Ligjit Themelor**: "Gjykatat zbatojnë dispozitat e Sheriatit Islam në rastet e sjella para tyre, sipas mësimeve të Kuranit të Shenjët dhe Thënieve e Veprave të Profetit si dhe rregullave tjera të nxjerra nga Shefi i Shtetit në pajtim të rreptë me Kuranin e Shenjët dhe Thëniet dhe Veprat e Profetit".

17 Shih, nenin 5 nën "b" ["Sistemi i Qeverisjes"] të **Ligjit Themelor**. Ky nen, në këtë pikë, përcakton se pasardhësit e themeluesit të dinastisë **Saud,** djemtë e djemve të tyre, do të jenë mbretër të **Arabisë Saudite**.

18 Shih nenin 56 ["Pushtetet e Shtetit"] të **Ligjit Themelor** në lidhje me fjalinë e fundit të nenit 44.2 si më sipër.

19 Për shtjellimet teorike të kësaj mundësie dhe të këtij ideali arab, shih më shumë në Bandar Eid Al Harbi, "Constitutionalism, Constitutionalisation and Legitimacy: Reforming *Al-Shura* Council Law in Saudi Arabia". *A Thesis Submitted for the Degree of Doctor of Philosophy in Law* (Law School Brunel University London: November 2014). Në internet: https://bura.brunel.ac.uk/handle/2438/10606 (shikuar në korrik 2017)

20 Lidhur me aspektet teorike dhe zhvillimin historik, shikuar nga këndi komparativ, në tri vendet islamike, dy me Islamin Sunni (**Arabia Saudite** dhe **Egjipti**) dhe një me Islamin Shia (**Irani**), ku ekziston ky institut kuranor, që merret me punët në interes publik, shih më shumë në: Alex Schank, "Constitutional Shari'a: Authoritarian Experiments with Islamic Judicial Review in Egypt, Iran, and Saudi Arabia". *The Georgetoën Law Journal* Vol. 102 Issue 2 (2014) fq. 519-550 në fq. 536-549.

njëjtë si organet tjera, dhe gjykojnë sipas normave dhe parimeve të Sheriatit Islam të mbështetur në **Kuran**, në **Thëniet dhe Veprat e Profetit Muhamet** dhe në rregullat e nxjerra nga mbreti[21].

7.2. Egjipti

Egjipti ndryshon dukshëm si nga **Arabia Saudite** ashtu edhe nga **Irani**. Nga ky i fundit dallon për shkak të ideologjisë shtetërore dhe vetë institucioneve, të cilat janë të ngarkuara me kontroll kushtetues të llojit islamik. E themi këtë të fundit sepse kontrolli gjyqësor modern në Egjipt ka nisur më 1940 dhe nuk bazohet në supremacinë e Kuranit dhe burimeve të tjera të së **Drejtës së Sheriatit**. Në aspektin institucional, ndërkaq, dallimi është edhe më i madh se në dy vendet si më sipër: **Egjipti** aktualisht ka një **Gjykatë Supreme Kushtetuese** (**GJSKE**), e cila ka nisur punën më 1979. Themelimi i saj qe paraparë me amendamentet kushtetuese të vitit 1971.

Në të kaluarën, gjatë shekullit XIX, por edhe më pastaj bazuar në legjislacionin e vitit 1956, gjykatat e **Sheriati**-t kanë operuar si pjesë e sistemit nacional gjyqësor. Juridiksioni i tyre, megjithatë, ka qenë i kufizuar kryesisht në çështjet e statusit personal (martesa, trashëgimia, shkurorëzimi etj.)[22]. Kontrolli kushtetues i bazuar në të **Drejtën e Sheriatit** nuk ka qenë në rend të ditës në këtë kohë: as teksti i kushtetues i vitit 1964, i draftuar në kohën e diktatorit të majtë egjipatian **Gamal Abdel Naser** (Gamal Abdel Nasser, 1918–1970), nuk përmend fare të **Drejtën e Sheriati**-t si pikë referimi për kontroll kushtetutshmërisë së ligjeve dhe të veprimit tjetër të pushtetit politik.

Vetëm shtatë vite më vonë, me amendamentet kushtetuese të vitit 1971, u parashikua se parimet e të **Drejtës së Sheriatit** do të shërbenin si burim kryesor i legjislacionit. Kjo qasje u ndryshua më shumë me Kushtetutën e vitit 1980, neni 2 i së cilës i dha të drejtë **GJSKE** për të kontrolluar nëse legjislacioni egjiptian është në pajtim me të **Drejtën e Sheriatit.**[23] Sikur u duk që kontrolli kushtetues në këtë vend fitoi premia të forta islamike, në sensin që tani e tutje pajtueshmëria e ligjeve me kushtetutë tani e tutje do të bëhej me parametra nga e **Drejta e Sheriatit**, ku përfshihen **Kurani** dhe **Thëniet dhe Veprimet e Profetit Muhamet.**[24] Kjo, megjithatë, vetëm në dukje është kështu: si dispozitat e amendamenteve të vitit 1971[25] ashtu edhe ato

---

21 Kjo bëhet e qartë në nenin 46 [“Pushtetet e Shtetit”] të Ligjit Themelor, i cili përcakton se “gjyqësori është një organ i pavarur dhe askush nuk ka autoritet ndaj gjyqtarëve përveç autoritetit të Sheriatit Islamik”.
Lidhur me këtë, një nen mjaft interesant është neni 8 [“Sistemi i Qeverisjes”] i **Ligjit Themelor**, i cili, në mënyrë ironike, flet për atë se si **Mbretëria e Arabisë Saudite** është “[...] një shtet i bazuar në premisat e drejtësisë, konsultimit dhe barazisë, në pajtim me Sheriatin Islamik”.

22 Alex Schank, “Constitutional Shari’a: Authoritarian Experiments with Islamic Judicial Review in Egypt, Iran, and Saudi Arabia”, fq. 529; Clark B. Lombardi & Nathan J. Brown, “Do Constitutions Requiring Adherence to Shari’a Threaten Human Rights? How Egypt’s Constitutional Court Reconciles Islamic Law with the Liberal Rule of Law”. *American University International Law Review* Vol. 21 Issue 3 (2006) fq. 379-435 në fq. 388.

23 Neni 2 [“Kapitulli I: Shteti”] i Kushtetutës së vitit 1971: “Islami është fe e Shtetit dhe gjuha arabe është gjuhë zyrtare e vendit dhe burim kryesor i legjislacionit është jurisprudenca islamike (Sheriati)”. Cf. *The Constitution of the Arab Republic of Egypt 1971 (as amended up to 2007).* Në internet: http:// www. wipo.int/ wipolex/ en/ details. jsp?id=7140 (shikuar në korrik 2017) Një dispozitë e ngjashme është stipluar edhe në **Kushtetutën e Egjiptit** të vitit 2014, aktualisht në fuqi. Në nenin 2 [“Islami, Parimet e Sheriati-t Islam”] të kësaj kushtetute qartë përcaktohet se “Islami është fe e Shtetit dhe gjuha arabe është gjuhë zyrtare e vendit. Parimet e Sheriati-t Islamik janë burimi parësor i legjislacionit.” Cf. *Constitution of Egjypt of 2014.* Në internet: https://www. constituteproject. org/ constitution /Egypt 2014.pdf (shikuar në korrik 2017).
Siç vërehet, në Kushtetutën e vitit 1971 si bazë për legjislacionin e këtij vendi është caktuar praktika islamike, kurse në Kushtetutën e viti 2014, flitet për parimet e Sheriat-it si burim. Kjo është bërë nga regjimi përmes një plebishiti të mbajtur më 22 maj 1980, me qëllim të forcimit të kredenciale të tij islamike të cilat në sytë e popullit i ka pasur të mangëta. Cf. Nathan J. Brown, “Judicial Review and the Arab World”, fq. 181.

24 Pas vrasjes me atentat më 6 tetor 1981, të presidentit të Egjiptit, **Anvar el Sadat** (Anëar al – Sadat: 1918-1981), pushteti përndoqi islamistët e vendit dhe u tërhoq nga iniciativa e kohës për të integruar më tutje të drejtën e Sheriatit në të gjitha kodifikimet e së drejtës civile, penale, tregtare, të procedurës së provave dhe të kodeve tjera procedurale. Megjithatë, neni 2 ngeli në fuqi në kohën e marrjes së pushtetit nga presidenti **Hosni Mubarak**, i cili dha dorëheqjen më 11 shkurt 2011 nën presionin e ngjarjeve të Pranverës Arabe në këtë vend.

25 Neni 174 [“Gjykata Supreme Kushtetuese”] i Kushtetutës së vitit 1971: “[...] Gjykata Supreme Kushtetuese e vetme bën kontrollin gjyqësor të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe të rregullave tjera dhe bën interpretimin e teksteve legjislative në mënyrën e përcaktuar me ligj. Ligji përcakton kompetencat tjera të Gjykatës, si dhe rregullon procedurat që duhen ndjekur në gjykimet pranë saj [...]”.

të Kushtetutës së vitit 1980, aktualisht në fuqi,[26] janë të redaktuara me një gjuhë shumë neutrale, klasike dhe tipike për dispozitat kushtetuese të vendeve që kanë juridiksion të ndarë kushtetues që ushtrohet nga një gjykatë e veçantë kushtetuese. As jurisprudenca e **GJSKE** nuk është ndryshe pos e tillë, neutrale dhe klasike, gjë kjo tipike për gjykatat kushtetues me juridiksion të ndarë në çështjet kushtetuese. Kjo cilësi e bën Egjiptin edhe më të veçantë dhe më të ndryshëm në krahasim me Arabinë Saudite dhe Iranin.

Kjo gjendje konfuze rreth nenit 2 si më sipër si dhe marrëdhënies së tij me dispozitat kushtetuese që kanë të bëjnë me **GJSKE**, bazuar në të cilat ajo luajti rolin e saj neutral dhe klasik në çështjet kushtetuese, duke bërë një interpretim tjetër, më liberal. Kjo qasje interpretative ndaj nenit 2 të Kushtetutës shpjegohet me vetë origjinën e tij si dhe me aftësinë e interpretuesit, **GJSKE**, për të përdorur një interpretim neoliberal, kur bëhet fjalë për përdorimin e nenit në fjalë si pikë referimi për kontrollin kushtetues të ligjeve egjiptiane. Të shohim njëherë origjinën e nenit 2.

Pas marrjes së pushtetit më 1970 në Egjipt, **Anvar el Sadat** u ndesh me një opozitë të fortë të proveniencës së majtë pro-sovjetike e trashëguar nga presidenti **Naser.** Në të njëjtën kohë, **Vëllazëria Muslimane**, grupi radikal islamist, paraqiste një rrezik të madh për marrjen e pushtetit me dhunë. I gjetur në një situatë të tillë, në mes të rrezikut të majtë që mbështetej nga ish BRSS dhe rrezikut të Islamit radikal të **Vllazërisë Muslimane**, e cila më vonë do të bëjë atentat në te, **Anvar al Sadat**, nisur nga nevoja për reforma liberale dhe tërheqjen e kapitalit të huaj në Egjipt, vendosi që të akomodonte në formë ndjenjat islamiste të shumicës së popullsisë vendase. Në veçanti pas vitit 1974, ai kishte nisur një valë reformash neo-liberale me të cilat synonte të fuste në tregun egjiptian kapitalin dhe investimet e huaja për të zhvilluar këtë vend të varfër arab. Kjo kërkonte një lloj sigurie juridike për të huajt dhe një kontroll gjyqësor të pushtetit, gjë që u arrit përmes futjes më 1980 të amendamentit të sipërcekur në nenin 2 të Kushtetutës së vitit 1971 me të cilin mundësohej kontrolli kushtetues islamik i legjislacionit të këtij vendi. Kjo i jepte një siguri për të huajt sepse mund të mbështeteshin te një organ siç ishte **GJSKE**, e cila mund të bënte kontrollin kushtetues të ligjeve që lidheshin me aktivitetin ekonomik të vendit. Kjo është arsyeja reale e zgjerimit të juridiksionit të **GJSKE** në vitin 1980 dhe saktësimit të dispozitës së nenit 2, i cili ishte futur në kushtetutë me amendamentet e vitit 1971.[27] Para këtij viti, gjykatat në Egjipt vetëm mund të mos zbatonin, përkatësisht të largonin mënjanë ligjet që i konsideronin si jo kushtetuese. Kjo bëhej, megjithatë, me vendime që nuk ishin të detyrueshme për askënd.[28]

Për të arritur reformimin liberal të Egjiptit, presidenti **Sadat** pranoi që në nenin 149 të Kushtetutës së vitit 1923, i cili thoshte se "[...] feja e Shtetit është Islami dhe gjuhë zyrtare është gjuha arabe [...]", të shtoheshin edhe fjalët "[...] dhe parimet e Sheriatit Islam janë një burim primar i legjislacionit". Kjo u bë me amendamentet e vitit 1971. Përveç shtyrjes së reformave liberale, presidenti **Sadat** nuk u ndal me kaq. Në vitin 1980, ai kishte nevojë që të rizgjidhej sërish president i vendit. Për të bërë këtë, ai bëri edhe një koncesion lidhur me nenin 2 të Kushtetutës, me kusht që **Vëllazëria Myslimane** dhe të tjerët të pajtoheshin që mandati i **Presidentit të Egjiptit**, i cili deri atëherë sipas nenit 77 të Kushtetutës së vitit 1971 kufizohej në dy mandate, të bëhej pa asnjë kufizim mandati. Me këtë ndryshim të nenit 77 të Kushtetutës, i cili tani thoshte se [...] Presidenti mund të rizgjidhet me mandate të vazhdueshme [...], erdhi edhe ndryshimi i nenit 2, i cili tani e tutje në vend të nyjës së pashquar

---

[26] Neni 192 ["Gjykata Kushtetuese Supreme: Juridiksioni"] i Kushtetutës së vitit 2014: "Gjykata Supreme Kushtetuese është kompetente në mënyrë ekskluzive për të vendosur lidhur me kushtetutshmërinë e ligjeve dhe rregulloreve, të bëj interpretimin e teksteve legjislative dhe të gjykoj kontestet që kanë të bëjnë me anëtarët e saj, në kontestet në mes të trupave të gjyqësorit dhe entiteteve që kanë mandat gjyqësor, në kontestet që kanë të bëjnë me zbatimin e dy vendimeve kundërthënëse, njëri nga të cilët është dhënë nga një organ gjyqësor apo ndonjë agjenci me mandat gjyqësor, kurse tjetri nga një trup tjetër, si dhe në kontestet që kanë të bëjnë me zbatimin e verdikteve dhe vendimeve të saj".

[27] Tamir Moustafa, "Law Versus the State: The Judicialization of Politics in Egypt". *Law & Social Inquiry* Vol. 28 Issue 4 (2003) fq. 883-930 në fq. 885.

[28] George N. Sfeir, *Modernization of the Law in Arab States:* an Investigation into Current Civil, Criminal and Constitutional Law in the Arab World (Austin & Winfield Publishers: Nevada, ***1998***) fq. 249.

që thoshte se Sheriati Islam do të jetë "një" burim primar, me të cilin qartë përcaktohej se [...] Islami Sharia do të jetë burim primar i legjislacionit".[29]

Sa i përket aftësisë së **GJSKE** dhe interpretimit të saj neoliberal, viti 1993, ka qenë pika e kthimit në këtë drejtim. Deri në këtë kohë, në praktikën gjyqësore të **GJSKE** ka pasur pak raste të rrëzimit të ligjeve mbi bazën e kontrollit substancial të kushtetutshmërisë të bazuar në nenin 2 të Kushtetutës. Rrëzimi i ligjeve kishte ndodhur kryesisht duke u bazuar në parregullsitë procedurale, me përjashtim të një rasti.[30] **GJSKE** nuk kishte definuar asnjëherë deri më 1993 se cili ishte kuptimi përmbajtësor i fjalisë "[...] parimet e Sheriatit Islamit janë burim primar i legjislacionit". Kjo në literaturë është arsyetuar me faktin se **GJSKE** nuk ka pasur asnjëherë në gjirin e saj gjyqtarë të trajnuar në të **Drejtën e Sheriatit** dhe se asnjëherë vetë nuk ka insistuar që të marrë mendimin e teologëve të drejtësisë islame me rastin e marrjes së vendimeve të veta.[31]

Në vitin 1993 ndodhi kthesa sepse në një rast që kishte të bënte me të drejtat e gruas së divorcuar për kompensim dhe të drejtën për mbajtjen e fëmijës pas divorcit, **GJSKE** sqaroi se çfarë nënkuptohej me dispozitën e nenit 2 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, ajo krijoi dy nivele interpretimi kuptimor. I pari kishte të bënte më normat e Islamit, të cilat burojnë nga **Kurani** dhe nga Thëniet dhe Veprat e Profetit Muhamet, ashtu siç janë thënë dhe bërë nga vetë ai, kurse niveli i dytë ka të bëj me parimet e **Sheriatit Islam,** të cilat i shërbejnë promovimit dhe ruajtjes së tij dhe që kanë të bëjnë me promovimin dhe mbrojtjen e fesë, jetës, arsyes, nderit dhe pronës. Jo kushtetutshmëria bazuar në nenin 2 të Kushtetutës krijohet vetëm nëse cenohen standardet nga niveli i dytë, pra nëse ligji nuk promovon dhe mbron parimet e **Sheriatit Islam** që kanë të bëjnë me promovimin dhe ruajtjen e fesë, jetës, arsyes, nderit dhe pronës. Sa i përket standardeve të nivelit të parë, ndërkaq, sipas këtij vendimi të **GJSKE,** ato janë absolute dhe të padiskutueshme sepse bazohen në normat autentike kuranore dhe në thëniet dhe veprat e vetë profetit **Muhamed**, pa asnjë ndërhyrje apo narracion nga tjerët.[32]

Ky interpretim i GJSKE nuk duhet të shikohet si një interpretim liberal që ka për qëllim sekularizimin e të drejtës egjiptiane deri në atë masë sa ta bëjë të pavarur nga **Sheriati Islam**, por më shumë si një riinterpretim i rregullave dhe parimeve të **Islamit** me qëllim të përshtatjes së shoqërisë egjiptiane ndaj nevojave dhe kërkesave të kohës.[33] Kjo qasje e **GJSKE** ka vazhduar edhe më pastaj me të njëjtin intensitet dhe përkushtim. Në literaturë, lidhur me këtë, përmendet rasti a.q **i mbulesës në shkolla**, ku sërish kjo gjykatë në mënyrë të vendosur bëri dallimin në mes të normave të **Sheriatit Islam** dhe parimeve të cilat promovojnë dhe ruajnë fenë, jetën, arsyen, nderin dhe pronën dhe të cilat janë objekt rregullimi ligjor nga ana e shtetit dhe mund të jenë kundërkushtetuese sipas standardeve tjera të përcaktuara dhe interpretuara nga kjo gjykatë që nga vitit 1993. Lidhur me mbulesën në shkolla, **GJSKE** gjeti se normat e Sheriatit kërkojnë mbulesën e pjesëve te dukshme të trupit, por jo të fytyrës dhe shuplakave të duarve. Për këtë arsye, ajo gjeti se nuk ishin kundërkushtetuese

---

29 Mohamed Abdelaal, "Religious Constitutionalism in Egypt: A Case Study". *The Fletcher Forum of World Affairs* Vol. 37 Issue 1 (Winter 2013) fq. 35-51 në fq. 36.

30 Alex Schank, "Constitutional Shari'a: Authoritarian Experiments with Islamic Judicial Review in Egypt, Iran, and Saudi Arabia", fq. 530-531.

31 Në **Egjipt**, rolin e juristëve fetarë dhe shoqatave fetare në interoretimin e ligjit e ka ndërpre në mënyrë graduale sundimtari i këtij vendi në kohën otomane, **Mehmed Ali Pasha**, kedivi i Egjiptit. Pas marrjes së pushtetit, ky sundimtar dërgoi për shkollim në vendet evropiane të rinjtë e vendit për të studiuar drejtësinë dhe nisi kodifikimin sipas modelit evropian ashtu që nuk kishte nevojë për juristët me edukim fetar dhe për shoqatat tjera fetare që bënin interpretimin e të drejtës së Sheriati-t. Cf. më shumë në Mohamed Abdelaal, "Religious Constitutionalism in Egypt: A Case Study", fq. 49 fusnota nr. 54 dhe literatura e cituar aty.

32 Cf. më shumë në Clark B. Lombardi & Nathan J. Brown, "Do Constitutions Requiring Adherence to Shari'a Threaten Human Rights? How Egypt's Constitutional Court Reconciles Islamic Law with the Liberal Rule of Law", fq. 416-425.

33 Mohamed Abdelaal, "Religious Constitutionalism in Egypt: A Case Study", fq. 39-41. Shih, po ashtu, arsyetimin e **GJSKE** lidhur me nenin 2 të Kushtetutës dhe rolin e kësaj gjykate në promovimin e demokracisë, standardeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut në një kontekst islamik dhe liberalizmin ekonomik, Clark B. Lombardi & Nathan J. Brown, "Do Constitutions Requiring Adherence to Shari'a Threaten Human Rights? How Egypt's Constitutional Court Reconciles Islamic Law with the Liberal Rule of Law", fq. 415 – 417.

urdhrat e shkollës që ndalonin **niqab**-in (femra duhet të mbulojë krejt trupin, duke lënë vetëm sytë të zbuluar). Sipas saj, vetëm **hijab**-i (mbulimi i kokës dhe qafës) lejohej sepse bënte pjesë në normat kuranore të cilat nuk mund të interpretoheshin e as të viheshin në dyshim nga ana e askujt, përfshirë **GJSKE.**[34]

Gjendja ndryshon në **Egjipt** kur flitet për aspektet tjera kushtetuese, pra për ato që nuk lidhen me interpretimin e nenit 2 të Kushtetutës: pas një sërë vendimesh të disfavorshme për regjimin në **Kajro**, të marrë nga **GJSKE** në fillim të viteve '90 të shekullit të kaluar në dobi të shoqërisë civile dhe akterëve të tjerë politikë, të cilat kishin të bënin me kufizimin e arbitraritetit të pushtetit, pushteti nisi të ndërhyjë në pavarësinë e këtij organi. Kjo dëshmon se zotimi i regjimit në **Egjipt** për idetë neoliberale që lidhen me pavarësinë e gjyqësorit dhe zbatimin neutral të së drejtës, ka kufizimet e veta, të cilat e bëjnë **GJKSE** jo aq të efektshme në arbitrimin në kontestet kushtetuese të karakterit të ndjeshëm politiko-kushtetues.[35] Për botën islame, megjithatë, **Egjipi** përben një precedent pozitiv dhe shembull për t'u ndjekur.

7.3. Irani

Irani, aktualisht një republikë islamike, bën pjesë në shtetin e dytë më teokratik në botën e sotme, pas Arabisë Saudite. Në pikëpamje të kontrollit të kushtetutshmërisë, ky vend ka një histori mjaft të varfër. Kjo vlen për të gjitha kushtetutat e këtij vendi, me fillim që nga ajo e para e vitit 1906 deri më sot.

Konstitucionalizmi iranian ka qenë i ndikuar nga zhvillimet e luftës për konstitucionalizëm në Perandorinë Osmane. Këto zhvillime kanë filluar me reformat e njohura si **Reformat e Tanzimatit** të vitit 1839, të cilat qenë kurorëzuar me nxjerrjen e **Kushtetutës së Perandorisë Osmane** në vitit 1876. Me këtë kushtetutë, Perandoria Osmane u bë shteti i parë islamik kushtetues. Ky regjim, megjithatë, nuk zgjati më shumë se dy vjet: **Sulltan Abdyl Hamiti** (Abdul Hamid II: 1842-1918) rrënoj parlamentin otoman dhe riktheu sundimin personal deri në prill të vitit 1909, kur u rrëzua nga froni nga ana e **Xhonturqve**. Efekti rrezatues i kësaj Kushtetute, në Iran zgjati më shumë se dy vite: në dekadat e fundit të shekullit XIX, atje vazhdoi shumë më fuqishëm lufta për konstitucionalizëm dhe kontroll të pushtetit despotik personal të shahëve iranianë të dinastisë **Qajar**. Kjo u bë kryesisht me ndihmën e madhe të intelektualëve në mërgim dhe të edukuar në vendet perëndimore.[36] Këta intelektualë kurorëzuan përpjekjet e tyre për një monarki kushtetuese më 1906, kur draftuan kushtetutën e parë të këtij vendi, e cila kufizonte përmes **Majlis**-it (Kuvendi Nacional) pushtetin financiar të Shahut dhe familjes së tij, si dhe disa prerogativa të tjera në politikën e jashtme. Sipas ndryshimeve dhe plotësimeve të tetorit të vitit 1907, sovraniteti buronte nga populli, i cili këtë sovranitet ia kishte bartur personit të Shahut të dinastisë **Qajar**. Kjo reflektohej edhe në tekstin e betimit që Shahu duhej ta jepte para **Majlis**-it dhe **Këshillit të Ministrave**, në të cilin lojaliteti i detyrohej Kushtetutës në emër të së cilës behej qeverisja me vendin.[37]

Kjo qasje, ku ndaheshin çështjet e fesë dhe të qeverisjes, domosdo që ka imponuar gjetjen e një zgjedhje në rast të mospajtimit në mes të Kushtetutës dhe fesë Islame të versionit **Shia**. Në çështjet e fesë, përkatësisht në rastet kur kishte mospërputhje në mes të ligjeve dhe **Kuranit** dhe të drejtës islamike

---

[34] Për vendimin integral në rastin në fjalë, i njohur si rasti nr. 8 i vitit gjyqësor nr. 17 i datës 18 maj 2006, shih më shumë në Nathan J. Brown & Clark B. Lombardi, "The Supreme Constitutional Court of Egypt on Islamic Law, Veiling and Civil Rights: An Annotated Translation of Supreme Constitutional Court of Egypt Case No. 8 of Judicial Year 17 (May 18, 1996)". *American University International Law Review* Vol. 21 Issue 3 (2006) fq. 437-460; Për komentet e këtij vendimi, shih në Clark B. Lombardi & Nathan J. Brown, "Do Constitutions Requiring Adherence to Shari'a Threaten Human Rights? How Egypt's Constitutional Court Reconciles Islamic Law with the Liberal Rule of Law", fq. 426-429.

[35] Alex Schank, "Constitutional Shari'a: Authoritarian Experiments with Islamic Judicial Review in Egypt, Iran, and Saudi Arabia", fq. 531-532.

[36] Laurence Lockhart, "The Constitutional Laws of Persia: An Outline of Their Origin and Development". *Middle East Journal* Vol. 13 No. 4 (Autumn, 1959), fq. 372-388 në fq. 375.

[37] Ibid. fq. 379.

të versionit **Shia**, parashikohej një lloj arbitrimi i një këshilli prej pesë vetash i përbërë nga kleri islamik **Shia.**[38] Në **Pakistan**, ta zëmë, këto konflikte në atë kohë i ka zgjedhur Gjykata Supreme,[39] kurse sot i zgjedh Gjykata Federale e Sheriatit.[40] Në **Iran**, kjo prerogativë iu la këtij trupi të përbërë prej jo më pak se pesë klerikësh islamikë të versionit **Shia**, por që me kohë Shahu e bëri të paefektshëm këtë trup.[41] Në këtë kushtetutë, por edhe në Kushtetutën e vitit 1925, e cila rrëzoj dinastinë **Qajar** të shahëve dhe vendosi disnastinë **Pahlavi**, nuk ka pasur asnjë dispozitë që flet për kontroll gjyqësor të kushtetutshmërisë, përkatësisht ndonjë mekanizëm apo procedurë për sigurimin e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës. E tillë ka qenë gjendja edhe pas vitit 1931, kur u themelua **Gjykata Supreme e Iranit** (GJSIra), formimi i së cilës, në fakt, qe parashikuar me ndryshimet dhe plotësimet e Kushtetutës në tetor të vitit 1907.[42] Në përgjithësi, **Irani** në asnjë fazë të zhvillimit të tij deri në Revolucionin e vitit 1979, nuk ka pasur një kontroll gjyqësor të veprimit ekzekutiv apo kontroll gjyqësor (apo politik) të kushtetutshmërisë së ligjeve.

Kjo mungesë e dispozitave rreth kontrollit të kushtetutshmërisë është për t'u çuditur nisur nga fakti se hartuesit e Kushtetutës së vitit 1906, por edhe të kushtetutave të mëpastajme deri në Revolucionin e vitit 1979, kanë qenë nën ndikimin e fuqishëm të kulturës juridike të Evropës Perëndimore.[43] Kjo shpjegon pse në këtë kohë kanë ekzistuar dy sisteme juridike, por që ka dominuar sistemi laik i së drejtës. Në format politike iraniane të kësaj periudhë ka dominuar një lloj monarkie kushtetuese, por vetëm në formë, ku nuk lejohej supremacia (epërsia) e Islamit të versionit **Shia** dhe ku ligjet ndryshoheshin dhe plotësoheshin sipas procedurave kushtetuese laike bazuar në nevojat e vendit, ashtu siç vlerësoheshin ato nga regjimi mbretëror. Kjo nënkupton se në këtë kohë, Irani kishte një legjislacion civil në të gjithë lëmenjtë e jetës, civile, administrative, penale, tregtare dhe kështu me radhë.[44] Kjo gjendje ka ndryshuar me Revolucionin e vitit 1979, ku si burim legjitimiteti nuk është më kushtetuta por vullneti metafizik i besimit në një Zot dhe në librin burimor të Islamit, Kuranin, plus në burimet tjera të versionit Shia të Islamit.

Koekzistenca e dy burimeve të së drejtës, **Sheriat**-i dhe **Urf-**i ("e drejta civile" apo e drejta laike në kuptimin e sotëm)), që kishte nisur që nga nxjerrja e Kushtetutës së vitit 1906, mori fund në vitin 1979. **Sheriat-i** interpretohej nga **Ulema**-të kurse **Urf**-i interpretohej nga qeveritarët lokalë sipas nevojave të kohës dhe hapësirës. Përveç **Ulema**-së, në **Islamin Shia** ka pasur një ndikim të madh edhe klasa e klerikëve

---

38 Në këtë kushtetutë, versioni Shia i Islamit që mbrohej bazohej në doktrinë **Ja'fari i Dymbëdhjetë Imamëve** dhe besimi në një Zot, Allahun dhe kjo përbënte pjesë të tekstit të betimit që përcaktohej në Kushtetutë dhe ishte feja zyrtare e **Iranit.** Ibid. fq. 379-380

39 Laurence Lockhart, "The Constitutional Laws of Persia: An Outline of Their Origin and Development", fq. 380 fusnota nr. 24.

40 Në nenin 203D (1) ["Gjykata Federale e Sharias: Pushteti, Kompetencat dhe Funksionet"] të **Kushtetutës së Republikës Islamike të Pakistanit** të vitit 1973, me amendamentet e vitit 2012, përcaktohet si vijon: "Gjykata (e Sheriatit) ka mundësi që, sipas kërkesës së qytetarit të Pakistanit, me vetiniciativë, me kërkesë të Qeverisë Federale apo të Qeverisë Provinciale, të bëjë shqyrtimin dhe të vendos lidhur me çështjen nëse një ligj ndonjë dispozitë ligjore është në kundërshtim me Urdhrat e Islamit ashtu siç janë përcaktuar në Kuranin e Shenjtë dhe në Thëniet e Profetit të Shenjtë, më tutje të referuara si Urdhrat e Islamit". Në pikën tre të nenit të njëjtë përcaktohen pasojat juridke në rast të këtij kundërshtimi dhe përdoret formulimi sipas të cilit, nën "a" ligjvënësi përkatës duhet ta amendamentojë ligjin dhe ta sjellë në pajtim me **Urdhrat e Islamit** për aq sa ligji apo dispozitat e tij janë kundër tyre, ose, nën "b", në të kundërtën ligji apo dispozita e tillë ngelet pa efekt juridik nga dita e marrjes së vendimit të Gjykatës (së Sheriatit). Cf. *Constitution of the Islamic Republic of Pakistan* (As modified up to the 28th February, 2012). Në internet: http://na.gov.pk/uploads/documents/1333523 681_951.pdf (shikuar në korrik 2017)

41 Asnjëherë gjatë sundimit të shahëve, sipas kësaj kushtetute, por edhe sipas kushtetutave e praktikave të mëvonshme të **Iranit** deri në Revolucionin e vitit 1979, ky këshill i klerikëve nuk ka qenë operativ, përkatësisht ka qenë një letër e vdekur. Kushtetuta e vitit 1906, në aspektin formal i jepte klerit islamik Shia, të njohur si **Mulla-t** dhe **Mujtahid-ët**, të drejtën e fjalës së fundit për të vërtetuar nëse ligjet e Iranit binin ndesh me Kuranin dhe me burimet tjera të versionit Shia të Islamit. Kjo në praktikë nga të gjithë shahët e Iranit deri me përmbysjen e tyre më 1979, nuk ka gjetur zbatim serioz dhe çdoherë pika e referimit të legalitetit dhe të "kushtetutshmërisë" së ligjeve ka qenë fjala e **Majlis-**it dhe e Shahut në vartësi të raportit të forcave në mes tyre. Laurence Lockhart, "The Constitutional Laws of Persia: An Outline of Their Origin and Development". fq. 381bis.

42 E. Burke Inlow, "The Supreme Court of Iran". *Osgoode Hall Law Journal* Volume 8 No. 3 (December 1970) fq. 549-557 në fq. 550 & 554.

43 Laurence Lockhart, "The Constitutional Laws of Persia: An Outline of Their Origin and Development", fq. 382-383.

44 Ibid. fq. 375 fusnota nr. 9.

të njohur si **Mujtahid**-ët, të cilën në fakt ishin dijetarë juridikë të shkolluar dhe kompetentë për të interpretuar jurisprudencën islamike sipas versionit **Shia.** Në fakt, **Mujtahid**-ët ekzistojnë edhe në versionin **Suni** të **Islamit**, por atje kanë një rol tërësisht të ndryshëm. Në ndërkohë që në **Islamin Suni** janë katër **Mujtahid** "absolut", si themelues të katër shkollave juridike, në **Islamin Shia** ekzistojnë **Mujtahid**-ët që kanë karakter absolut për shkak se mund të kritikojnë dhe kontrollojnë veprimet e sundimtarit, i cili konsiderohet nga ta si një ruajtës i thjeshtë i rendit deri në ardhjen e **Imam Mahdi**-së, apo **Imamit të Fshehur** në ditët e fundit të botës (apokalipsi). Kjo qasje mesianike e Islamit Shia, shumë e ngjashme me kulturën fetare hebreje, ka qenë dhe vazhdon të jetë një faktor i fuqishëm i kohezionin shoqëror të shoqërisë iraniane.

Në **Iran**, ky rol i këtyre dijetarëve të drejtësisë dhe jurisprudencës islamike u rrit kur ndodhi Revolucioni i vitit 1979 dhe në krye të tij erdhi si lider apo imam **Ajatollah Homeini** (**Ayatollah Khomeini: 1902-1989**). Ky revolucion përmbysi tërësisht rendin kushtetues, i cili në njëfarë mase kishte arritur të krijojë një sistem civil të qeverisjes dhe lojalitete që nuk ishin fisnore apo fetare, por bazoheshin në kushtetutë e ligj dhe në lojalitetet të diktaturës së shahëve të dy dinastive si më sipër.

Revolucioni u reflektua në dispozitat e kushtetutës së re të Iranit, e nxjerrë në vitin 1979, e cila është në fuqi me disa amendamente të mëvonshme.[45] Sipas kësaj Kushtetute as që mund të bëhet fjalë për ndonjë kontroll të kushtetutshmërisë. Kjo për faktin se me te është bërë, në fakt, kodifikimi i pushtetit absolut të klerit **Shia**, në krye të të cilit gjendet **lideri suprem i Iranit**. Në këtë sistem kushtetutës, Kushtetuta dhe ligjet duhet t'i nënshtrohen interpretimeve absolute të klerit **Shia** dhe të **liderit suprem të Iranit**, jo anasjelltas. Në fakt, Kushtetuta barazohet me rregullat, ligjet dhe veprimet e zakonshme administrative të shtetit. Si të tilla, ato i nënshtrohen kontrollit gjyqësor administrativ me qëllim të konstatimit nëse ato kanë cenuar të drejtat e popullit ashtu siç interpretohet kjo e drejtë nga lideri suprem. Kjo do të thotë se Kushtetuta shihet si një akt zbatimi i të cilës përbën një veprim të zakonshëm administrativ nga ata që janë të thirrur për ta zbatuar dhe, si e tillë, ajo mund të shkelë të drejtat e popullit, të drejta që mund të mbrohen shkeljet eventuale përmes procedurës gjyqësore administrative.[46] Këtu nuk bëhet fjalë për supremaci (epërsi) të Kushtetutës, që cilësohet si një akt administrativ që duhet të jetë në harmoni të drejtën e Sheriatit ashtu siç kuptohet dhe interpretohet kjo e drejtë nga dijetarët e Islamit të versionit **Shia**, por për supremacinë e kësaj të fundit

Të shohim si duket më nga afër sigurimi i supremacisë (epërsisë) së Kuranit dhe burimeve tjera të së drejtës Islamike të versionit Shia, pra jo supremacia (epërsia) e Kushtetutës, e cila, siç u tha, ka karakterin e një akti të thjeshtë administrativ që mund të shkaktojë cenim të të drejtave të popullit dhe padrejtësi të tjera që mund të korrigjohen përmes kontrollit gjyqësor administrativ të veprimeve të autoriteteve publike (shtetërore) të ndërmarra në bazë të Kushtetutës.

Kushtetuta e Iranit e vitit 1979 bën pjesë ndër kushtetutat më interesante të kohës së sotme: ajo ka një narrativ që ngjason me përshkrimin e ardhjes së profetit të ri dhe paraqitjes së shenjave të dallueshme të ardhjes së botës së re në të cilën duhet të jetohet nën kërcënim të një apokalipsi po nuk u plotësuan dhe ndiqen dëshirat dhe thëniet e **Kuranit**, **Thëniet dhe Veprimet e Profetit Muhamed** dhe **Imamit të Fshehur**, të cilat dëshira dhe thënie janë të cituara në fillim të këtij narrativi kushtetues.

Pjesa operative e Kushtetutës nis me Zotin (Allahun), si një dhe i vetëm, si burim i krejt krijimit dhe ligjvënies, vijon me **Islamin** si pikë referimi për ekonomi dhe për çdo veprim njerëzor e shtetëror,[47] për të kaluar në mënyrë të qartë në definimin e statusit të Kushtetutës në kuadër të rendit iranian socio-politik.

---

45 *The Constitution of the Islamic Republic of Iran of 1979 with Amendments through 1989*. Në internet: https://www.constituteproject.org/constitution/Iran_1989.pdf?lang=en (shikuar në korrik 2017).

46 Askar Jalalian & Parisa Anvari, "A comparative study of judicial control in Iran, U.S.A and Canada." *International Letters of Social and Humanistic Sciences Online: 2014-12-15 ISSN: 2300-2697* Vol. 44, fq. 61-73 në fq. 62. Në internet: doi:10.18052/www.scipress.com/ILSHS.44.61 (shikuar në korrik 2017).

47 Cf. Nenet 1-3 ["Kapitulli I: Parimet e Përgjithshme"] të Kushtetutës.

Dispozitat mbi rendin islamik si parametër bazik për zhvillimin, gjykimin dhe interpretimin e çdo aspekti të jetës bëjnë pjesë në dispozitat kushtetuese që nuk mund të amandamentohen.[48] Sipas nenit 4 të Kushtetutës, jo vetëm ligjet dhe aktet tjera juridike, por edhe secili nen i Kushtetutës duhet të jetë në pajtim të plotë me parametrat e Islamit, kurse juristët e jurisprudencës (**fuqaha**) dhe të drejtës islamike (**fiqh**) që përbëjnë **Këshillin e Gardianëve** janë gjyqtarë të kësaj çështjeje. Këshilli, jo **Majlis**-i (Asambleja), paraqitet si organi kryesor i kontrollit kushtetues sipas kritereve islamike. **Majlis**-i ka vetëm funksion këshillues ligjvënës dhe asgjë më shumë: çdo aktivitet i tij i nënshtrohet kontrollit kushtetues sipas kritereve islamike, që kryhet nga **Këshilli Gardianëve.**[49] Kjo reflektohet që në emrin e organit ligjvënës, i cili ka cilësorin "konsultativ", përkatësisht **Asambleja Konsultative Islamike.** Çdo ligj i Asamblesë, sipas nenit 98, i nënshtrohet kontrollit nga **Këshilli i Gardianëve**, i cili brenda dhjetë ditësh vlerëson nëse ai ligj është në pajtim me kriteret e Islamit dhe me Kushtetutën. Ligji konsiderohet i zbatueshëm, sipas po këtij neni, vetëm atëherë kur Këshilli ka dhënë leje, përkatësisht përgjigje pozitive për ligjin e kontrolluar. Në të kundërtën, nëse Këshilli gjen se ligji nuk është në pajtim kriteret e Islamit dhe me Kushtetutën, atëherë ligji kthehet në Asamble, e cila duhet ta sjellë atë në harmoni me urdhrat e dhëna nga Këshilli.

Veprimtaria, funksionet dhe pozita e **Këshillit të Gardianëve** normohet me nenet 91-99 ["Autorizimet, dhe Autoriteti i Asamblesë Konsultative Islamike"] të Kushtetutës. Sikundër shihet, në Kushtetutë nuk ka kapitull të veçantë që flet për **Këshillin e Gardianëve**. Veprimtaria, funksionet dhe pozita e tij rregullohen në kuadër të **Majlisi**-it (Asamblesë). Ky organ, megjithatë, është më i fuqishmi dhe kryesori në çështjet kushtetuese: neni 98 i Kushtetutës shprehimisht i jep atij të drejtën për të kryer interpretimin kushtetues, i cili bëhet me pëlqimin e tri të katërtave të anëtarëve të tij. Detyrë e tij primare, në thelb, nuk është interpretimin i Kushtetutës por, bazuar në redaktimin e nenit 91 të Kushtetutës, shqyrtimi i pajtueshmërisë së legjislacionit të **Asamblesë Konsultative Islamike** me Islamin me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së rregullave islamike dhe Kushtetutës.

Këshilli ka një përbërje interesante: gjashtë anëtarët e tij janë nga komuniteti **fuqaha** që kanë njohuri në jurisprudencën dhe të drejtën islamike (**fiqh)**, kurse gjashtë të tjerë vijnë nga juristë laikë që janë specialistë të fushave të ndryshme të së drejtës. Në ndërkohë që të parët caktohen nga **lideri suprem i Iranit**, të dytët zgjidhen nga **Asambleja Konsultative Islamike** (**Majlis**-i).[50] Jo vetëm kaq! Kjo mënyrë e vënies së tyre në pozitë reflektohet edhe në kompetencat e dy grupeve të juristëve iranianë: sipas nenit 96 të Kushtetutës, pajtueshmërinë e ligjeve të Asamblesë me ligjet e Islamit e bën më shumicë votash grupi **fuqaha**, kurse pajtueshmërinë e ligjeve të Asamblesë me Kushtetutën e bën **Këshilli i Gardianeve** si tërësi me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve. Kjo do të thotë se grupi i dytë nuk ka fuqi për të bërë interpretimet e ligjeve të Islamit në mënyrë të ndarë, por kjo i takon grupit të parë të dijetarëve, **fuqaha**.

Lexuesi mund të presë që grupi i dytë të ketë kompetencë për interpretim të Kushtetutës, por kjo nuk është kështu, sepse Kushtetuta ka fuqi juridike si çdo ligj tjetër dhe duhet të bazohet në kriteret islamike. Fundja, Kushtetuta është draftuar dhe miratuar, jo nga një kuvend kushtetues (asamble konstitutive), por nga një **Kuvend i Ekspertëve të Iranit.** Kjo konstatohet në pjesën e fundit të narrativit fillestar të Kushtetutës, i cili më pas ndiqet nga Preambula dhe pjesa operative e Kushtetutës, e cila përbëhet nga 175 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë) nene.

Nga kjo shihet qartë se **Irani,** pas vitit 1979, ka ofruar sfidën më të ashpër dhe më serioze ndaj konstitucionalizmit modern, të bërë ndonjëherë nga një vend islamik. Kjo për faktin se në këtë vend ekzistojnë njëfarë ndarje e pushtetit dhe një lloj kuvendi përfaqësues, por funksionojnë sipas parimeve të Kuranit dhe burimeve të tjera të Sheriatit.[51] Përveç kësaj, sfida e **Iranit** shihet edhe në atë se nenet 4 dhe 5 ["Parimet e Përgjithshme"] të Kushtetutës së vitit 1979, fuqizojnë një sundim të juristëve, i cili ngelet

[48] Cf. Paragrafi i fundit i nenit 177 të Kapitullit XIV ["Ndryshimi i Kushtetutës'] të Kushtetutës

[49] Cf. Neni 91.1 ["Autorizimet, dhe Autoriteti i Asamblesë Konsultative Islamike"] i Kushtetutës.

[50] Neni 91. 1 & 2 ["Autorizimet, dhe Autoriteti i Asamblesë Konsultative Islamike"] i Kushtetutës.

[51] Chibli Mallat, "On the Specificity of Middle Eastern Constitutionalism", fq. 34–35.

në fuqi deri në kthimin e "Imamit të Fshehur" (**Mahdi**). Ky sundim quhet **velayat-e faqih**.[52] Dhe, si i tillë, realizohet përmes një aparati shtetëror të krijuar për këtë qëllim, i sipërcekuri **Këshilli Gardianëve**, me qëllim të sigurimit që të gjitha ligjet dhe rregullativa tjetër shtetërore bazohen në "kritere islamike". Kjo nuk është e tëra, megjithatë: **Lideri Suprem i Iranit,** më 1988, krijoi një trup të quajtur **Këshilli i Interesit Publik** (**Maslahat**), i cili në emër të interesit publik ka kompetencë për të rrëzuar vendimet e **Këshillit të Gardianëve** dhe të ndërmjetësojë në konfliktet në mes të **Majlis**-it dhe **Këshillit të Gardianëve**. Krijimi i këtij trupi shihet si i kundërt me parimin revolucionar iranian mbi sundimin e juristëve, **velayat-e faqih**.[53]

7.4. Vendet e Magrebit: Algjeria, Maroku dhe Tunizia

Nga vendet e **Magrebit**, kemi zgjedhur të përjashtojmë **Libinë** për arsye krejt pragmatike: në atë vend, që nga rrëzimi nga pushteti i diktatorit kolonel **Muhamer Gadafi,** më 20 tetor 2011, (Muammar Mohammed Abu Minyar Gaddafi: 1942-2011), vendi gjendet në një kaos të veçantë dhe vështirë se mund të flitet për ndonjë "konstitucionalizëm libian" në kontekstin aktual. Në të njëjtën kohë, as e kaluara historike e këtij vendi nuk përbën ndonjë tregim të veçantë lidhur me aspektet nga fusha që trajtohet në këtë libër. Ajo çfarë shihet si trend në rastin libian është se vendet evropiane kanë shprehur dhe po tregojnë që nga vitit 2011 një interesim të madh për rikthimin e stabilitetit dhe zhvillimin socio-ekonomik të këtij vendi për shkaqe të sigurisë së tij dhe ndikimit që ky vend ka në kontinentin e vjetër, si pasojë e afërsisë, në veçanti për shkak të rrezikut që është duke paraqitur kaosi në Libia që po shërben si një vend transit për valën e refugjatëve nga Afrika.

Jo vetëm si pasojë e afërsisë gjeografike me Evropën, por edhe si pasojë e të kaluarës së përbashkët koloniale, vendet që trajtohen këtu, në shumë aspekte trajtohen si një njësi e përbashkët studimi dhe vrojtimi. Tema që diskutojmë këtu, gjyqësia kushtetuese dhe konstitucionalizmi në përgjithësi, nuk përbën ndonjë përjashtim. Këto vende, përveç që janë pjesë e botës arabe, gjithashtu si pasojë e afërsisë me atë botë, si dhe fakti që janë me stof kulturor islamik dhe Islami ka pasur një ndikim të madh në zhvillim e tërësishëm të këtyre vendeve, e bën edhe më serioz trajtimin e tyre në këtë kuadër.

U mor vesh, specifikat që ekzistojnë në këto vende, janë ato që ne i theksojmë me këtë rast në një mënyrë të veçantë. Në rend të parë i kemi theksuar karakteristikat e përgjithshme, të cilat, siç u tha më lart, i bëjnë këto vende të dallueshme nga të tjerët në botën arabe dhe islamike. Specifikat në fushën e konstitucionalizmit modern kryesisht lidhen me historinë e tyre koloniale dhe ndikimin e madh që Evropa ka pasur në këto vende gjatë shekujve të kaluar. Në këtë drejtim, Franca e Italia kanë luajtur një rol të veçantë. Kjo sepse Libia ka qenë një kohë koloni franceze, kurse vendet tjera të **Magrebit** kanë qenë një kohë të gjatë protektorat absolut francez ashtu që Franca dhe kultura e saj kanë qenë përcaktuese të zhvillimit politik dhe kushtetues në këto vende. Të shohim në vijim si duket kjo.

Në **Algjeri** në fuqi është Kushtetuta e vitit 1963, e para pas pavarësimit të këtij vendi nga Franca pas një kohe të gjatë të dominimi kolonial. Ajo ka pasur amendamentime të thella më 2002, 2008 dhe 2016. Me amendamentet e fundit në vitin 2016, u parashikua ndarja e pushtetit.[54] Kjo ndarje, megjithatë, nuk përcaktohet sipas standardeve perëndimore: sipas vetë tekstit të Kushtetutës, **Asambleja Popullore Nacionale (APN)**, njëra prej dy dhomave të parlamentit algjerian, paraqitet si kuadri kontrollues i të gjitha

---

52 Alex Schank, "Constitutional Shari'a: Authoritarian Experiments with Islamic Judicial Review in Egypt, Iran, and Saudi Arabia", fq. 528.

53 Ibid. fq. 529, 535.

54 Kapitulli III, neni 14.1 ["Shteti"] i Kushtetutës së Amandamentuar në vitin 2016: "Shteti bazohet në parimet e organizimit demokratik, ndarjen e pushteteve, dhe drejtësinë sociale". REPUBLIQUE ALGERIENNE DEMOCRATIQUE ET POPULAIRE: PRESIDENCE DE LA REPUBLIQUE.SECRETARIAT GENERAL DU GOUVERNEMENT, *CONSTITUTION DE LA REPUBLIQUE ALGERIENNE DEMOCRATIQUE ET POPULAIRE* (Mars 2016). Në internet: http://www.joradp.dz/TRV/FCons.pdf (shikuar në korik 2017).

pushteteve politike.[55] Kjo nuk është çudi, nisur nga fakti se **Algjeria** ka qenë për një kohë të gjatë shtet i bazuar në ideologjinë moniste socialiste ku kuvendi paraqitet si organi më i lartë i pushtetit, që konsiderohej unik dhe të pandarë. Nga kuvendi derivon legjitimiteti politik i pushteteve të tjera, me partinë e proveniencës së majtë algjeriane si avangardë të vetme për të definuar interesat e masave të gjëra popullore.[56]
Sado që me amendamentet e vitit 2002, janë bërë ndryshime në sistemin politik, duke lejuar pluralizmin politik në vend, roli i **APN** si një organ kushtetues kontrollues, ka ngelur në fuqi sot e kësaj dite. Në dispozitat ku flitet për **Këshillin Kushtetues** (KKA), amendamentet e vitit 2016 në Kushtetutën e vitit 1963, bëjnë fjalë edhe për organet e kontrollit. **KKA** modelohet sipas shembullit të **Francës**, siç do të shihet në vijim, si në formë ashtu dhe në përmbajtje.
Organet si më sipër të kontrollit gjenden në kuadër të **APN** janë të autorizuara për të bërë kontrollin e veprimit ekzekutiv dhe legjislativ si dhe pajtueshmërinë e veprimeve të tilla me Kushtetutën.[57] Krahas këtyre organeve, Presidenti i Republikës paraqitet si garantuesi i parë i saj. Kjo dispozitë gjendet në të gjitha amendamentet në **Kushtetutën e Algjerisë** të vitit 1963 e deri më sot.[58]
Ky format i organizimit të pushtetit në **Algjeri**, i sanksionuar me Kushtetutë, që fare nuk korrespondon me asnjë nga strukturat para-koloniale autoktone algjeriane, për dallim nga **Maroku**, vjen si pasojë e ndikimit kolonial evropian përgjatë shekullit XX. Sa i përket organizimit të pushtetit, krahas ndikimit kolonial, ish-**Bashkimi Sovjetik** ka pasur po ashtu një ndikim të madh ideologjik në zgjidhjet kushtetuese algjeriane, në veçanti kur flitet për rolin dhe pozitën e një partie të vetme, **Frontit Nacional Çlirimtar (FNÇ)**, në legjitimimin e strukturave të reja të pushtetit në **Algjeri** pas fitimit të pavarësisë së saj.[59]

KKA, sipas formës dhe përmbajtjes, ngjason shumë me sistemin francez. Kjo ngjashmëri ekziston për dy arsye. Në rend të parë, ai nuk është pjesë e gjyqësorit por një institucion i pavarur i kontrollit kushtetues i krijuar me qëllim të mbrojtjes së ekzekutivit algjerian nga tirania dhe pushteti suprem i **APN**, njëjtë si në **Francën** e **Republikës së Pestë**. Në rend të dytë, juridiksioni i **KKA** është ndarë dhe i përngjan shumë rastit francez sepse fokusohet kryesisht në kontrollin preventiv të kushtetutshmërisë.

Ta shohim si duket kjo me amendamentet kushtetuese të vitit 2016 në Kushtetutën e vitit 1963. Para se të kalojmë në këtë, vlen të theksohet këtu se në **Algjeri,** fe zyrtare është **Islami**. Të gjitha kushtetutat algjeriane kanë parashikuar themelimin e një këshilli të lartë islamik, që ekziston pranë Presidentit të Republikës, me qëllim të dhënies së këshillave rreth çështjeve të Islamit.[60] Islami, megjithatë, nuk shërben si bazë për legjislacionin e këtij vendi apo për veprim tjetër të autoriteteve publike. Si fe zyrtare, ai paraqet vetëm pjesë të identitetit të tërësishëm kushtetues algjerian, asgjë tjetër.[61]

---

55 Kapitulli III, neni 14.1 [“Shteti”] i Kushtetutës së amendamentuar në vitin 2016: “Asambleja e zgjedhur përbën kuadrin brenda të cilit shprehet vullneti i popullit dhe ushtrohet kontrolli i veprimit të pushteteve publike”. Dispozitë e njëjtë ka ekzistuar që nga fillimi i jetës kushtetuese të këtij vendi, gjë që shihet nga fakti se kjo dispozitë ka ekzistuar e pandryshuar edhe në Kushtetutën e Algjerisë të 10 shtatorit 1963, e cila në nenin 28 [“Ushtrimi i Sovranitetit. Asambleja nacionale”] parashikonte një zgjidhje identike me këtë si më sipër. Cf. Constitution of Algeria of 10 September 1963. Në inetrnet: http://mjp.univ-perp.fr/constit/dz1963 htm#7 (shikuar në korrik 2017).

56 Cf. Neni 23 [“Fronti Nacional Clirimtar”] i Kushtetutës së Algjerisë të vitit 1963: “ Fronti Nacionalçlirimtar është parti e vetme dhe avangardë në Algjeri” ; Neni 25: “Fronti Nacional Çlirimtar reflekton aspiratat më të thella të masave, i edukon, i kornizon dhe i udhëheq në drejtim të realizimit të aspiratave të tyre”; dhe Neni 26: “Fronti Nacional Çlirimtar realizon objektivat e revolucionit popullor dhe demokratik dhe ndërton socializmin në Algjeri”.

57 Cf. Titulli III [“Mbi Kontrollin, Mbikëqyrjen e Zgjedhjeve dhe Institucionet Konsultative”] i Kushtetutës së amendamentuar në vitin 2016.

58 Cf. Amendamentet e vitit 2016 në Kushtetutën e vitit 1963, neni 70.1 [“Pushteti Ekzekutiv: Presidenti”] i Kushtetutës: “[...] Ai është garantues i Kushtetutës [...]”.

59 George Joffe, “Morocco: Monarchy, Legitimacy and Succession”. *Third World Quarterly* Vol. 10 Issue 1 (1988) fq. 201-228 në fq. 203-204.

60 Cf. Amendamentet e vitit 2016 në Kushtetutën e vitit 1963, nenet 171-172 [“Mbi Institucionet Konsultative”].

61 Neni 212 [“Amendamentimi i Kushtetutës”] i Kushtetutë së amendamentuar në vitin 2016: “Amendamenti kushtetues nuk do te prekë [...] 3. Islamin, si fe shtetërore [...]”.

Pozita dhe roli kushtetues i **KKA** normohet në kuadër të organeve të kontrollit.[62] Për herë të parë ky organ i kontrollit kushtetues është parashikuar me Kushtetutën e vitit 1963. Kjo kushtetutë ka pasur vetëm dy nene për **KKA**: nenet 163 dhe 164 ["Këshilli Kushtetues"]. Në nenin e parë rregullohej struktura dhe përbërja e tij, kurse në nenin e dytë definohej funksioni dhe pozita. Sa i përket juridiksionit, **KKA**, sipas këtij neni, "[...] gjykonte lidhur me kushtetutshmërinë e ligjeve dhe urdhrave legjislative sipas kërkesës së Presidentit të Republikës dhe Kryetarit të Asamblesë Nacionale". Dy nenet, si më sipër, kanë pësuar ndryshime në të gjitha drejtimet, mirëpo pozita dhe juridiksioni i **KKA** kanë ndjekur qëllimin për të cilin ky organ është themeluar në fillim, siç u cek më sipër, përkatësisht për të mbrojtur ekzekutivin algjerian nga organi përfaqësues.

Nenet 182, 186, 188 dhe 190 të Kushtetutës së vitit 1963, normojnë në një mënyrë çuditërisht të shkapërderdhur juridiksionin e **KKA**. Në paragrafin e parë të nenit 182 definohet natyra e organit, i cili cilësohet si një organ përgjegjës për të kontrolluar respektimin e Kushtetutës së Algjerisë. Paragrafi në vijim i nenit të njëjtë e vë në ngarkesë të **KKA** edhe një funksion shtesë mbikëqyrës, që ka të bëjë me tri çështje si vijon: e para, me mbikëqyrjen e rregullshmërisë së referendumit, e dyta, me mbikëqyrjen e zgjedhjeve për president të Algjerisë; dhe, e treta, mbikëqyrjen e zgjedhjeve parlamentare. Në tri këto çështje, thuhet në paragrafin e fundit të këtij neni, **KKA** e ka fjalën e fundit si dhe merr pjesë në procedurat ankimore gjatë vijimit të tri procedurave si më sipër.

Kontrolli preventiv abstrakt i normës juridike përcaktohet me nenin 186. Në paragrafin e parë të këtij neni përcaktohet autorizimi i **KKA** për të dhënë mendim lidhur me kushtetutshmërinë e traktateve, ligjeve dhe rregulloreve. Me kërkesën e Presidentit, thuhet në paragrafin në vijim, KKA mund të japë mendime të detyrueshme lidhur me kushtetutshmërinë e ligjeve organike. Në paragrafin e fundit të këtij neni specifikohet se edhe rregulloret e punës së dy dhomave të **Kuvendit të Algjerisë** i nënshtrohen kontrollit kushtetues pas aprovimit të tyre.

Sipas dispozitës së nenit 165 të Kushtetutës, e cila ka qenë në fuqi deri me amendamentet e vitit 2016, në mënyrë shprehimore është bërë dallimi në mes të rasteve kur mendimi i KKA ka qenë i detyrueshëm dhe rasteve kur ky nuk ka qenë rasti. Në rastin e parë bëhej fjalë për norma juridike që kanë qenë të gatshme për t'u ekzekutuar, kurse në të dytin fjala ka qenë për norma juridike që akoma nuk kanë qenë të miratuara. Në fakt, ky nen ka theksuar se në rastin e parë prononcimi i KKA ka natyrën e mendimit, kurse në të dytin natyrën e vendimit.[63] Sidoqoftë, në të gjitha rastet, fjala ka qenë për kontrollin preventiv të normave juridike, pra para hyrjes së tyre në fuqi. Kjo vlen edhe për mendimet lidhur me traktatet ndërkombëtare: nëse një traktat është vlerësuar si kundërkushtetues nga ana e **KKA**, atëherë ai nuk ka mundësi të ratifikohet.[64]

Risia kryesore me amendamentet kushtetuese të vitit 2016, ka të bëjë me **kontrollin kushtetues incidental**. Ky kontroll nuk ka qenë i njohur në praktikën gjyqësore kushtetuese algjeriane në të kaluarën. Me këtë amendament përcaktohet se [...] nëse njëra nga palët në një procedurë gjyqësore pranë një gjykate vlerëson se ligji i aplikueshëm në një rast konkret, i cili është përcaktues i fatit të rastit, cenon të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë", atëherë pala në fjalë mund ta ngritë çështjen e kushtetutshmërisë së tillë të ligjit të tillë të aplikueshëm. Mirëpo, një ngritje e tillë nuk mund të bëhet ndryshe pos përmes **Gjykatës Supreme** apo **Këshillit të Shtetit**.

---

62 Cf. Nenet 178-192 ["Titulli i Tretë: Mbi Kontrollin, Monitorimin e Zgjedhjeve dhe Institucionet Konsultative. Kapitulli I: Kontrolli"] të Kushtetutës së amendamentuar në vitin 2016.

63 Cf. Neni 165 ["Titulli III: Lidhur me Institucionet e Kontrollit dhe Këshillimit. Kapitulli I. Kontrolli"] i Kushtetutës së vitit 1963, me amendamentet e vitit 2016.
CONSTITUTION DE LA REPUBLIQUE ALGERIENNE DEMOCRATIQUE ET POPULAIRE. Në internet: http:// publicofficialsfinancialdisclosure.worldbank.org/sites/fdl/files/assets/law-library-files/Algeria_Constitution_1963 % 20amended%202008_fr.pdf (shikuar në korrik 2017).

64 Neni 190 i Kushtetutës së vitit 1963, e amendamentuar në vitin 2016 (edhe dispozitat e amendamenteve në fuqi në periudhën në mes të viteve 2002-2008 kanë parashikuar një zgjidhje të tillë).

Sikundër shihet nga ky diskutim, mjaft zgjidhje kushtetuese algjeriane janë të ngjashme me ato franceze kur flitet për kontrollin e kushtetutshmërisë: në Francë, që nga vitit 2010, është futur kontrolli represiv i kushtetutshmërisë së ligjeve nëse kjo kushtetutshmëri ngrihet nga ana e palëve, përmes **Gjykatës Supreme** apo **Këshillit të Shtetit**, gjatë një procedure gjyqësore në të cilën çmohet se mund të vij deri te cenimi i të drejtave dhe lirive në rast të zbatimit të normës së tillë juridike kushtetutshmëria e së cilës sfidohet në një procedurë konkrete gjyqësore.

Maroku përbën një rast mjaft interesant për shkak se ky vend ka qenë nën protektorat të **Francës** dhe **Spanjës**, i krijuar më 1912 në bazë të **Traktatit të Fezit**.[65] Në të njëjtën kohë, **Algeria** dhe **Tunizia** më 1830 dhe 1881, respektivisht ishin absorbuar në gjirin e shtetit francez në tërësi, duke humbur çdo identitet juridiko-ndërkombëtar apo kushtetues. Në këtë aspekt, çdo diskutim lidhur me kontrollin e kushtetutshmërisë në këtë vend ka kuptim, njëjtë si më rastin e **Algjerisë** dhe **Tunizisë**, vetëm pas fitimit të pavarësisë së këtyre vendeve nga në gjysmën e dytë të shekullit XX. Ky moment për Marokun është viti 1956, kur ky vend ka fituar pavarësinë nga Franca.

Për dallim nga Algjeria dhe Tunizia, megjithatë, **Maroku** përbën një rast unik edhe në një aspekt tjetër, përveç atij që lidhet me protektoratin franko-spanjoll: në mesin e vendeve të Magrebit, është i vetmi vend që, pas fitimit të pavarësisë, ka arritur të restaurojë një pjesë të caktuar të strukturave dhe institucioneve politike parakoloniale, të cilat kanë shërbyer si bazë për të legjitimuar pushtetin e ri maroken. Kjo në veçanti vërehet në çështjen e mbledhjes së taksave, por edhe më aspekte të tjera të rëndësishme të organizimit dhe ushtrimit të pushtetit politik. Kjo ka ndodhur si pasojë e faktit që mbretërit marokenë, në mes të dy luftërave botërore dhe menjëherë pas vitit 1945, kanë arritur të lidhen me **Istiqlal**, lëvizjen nacionaliste marokene për pavarësi nga **Franca**, duke legjitimuar kështu monarkinë përmes një shijeje të theksuar nacionaliste. Ndryshe do të kishte qenë e vështirë për mbretërit **marokenë** për të frenuar apetitet për pushtet të fiseve të vendit.[66]

Gjashtë vjet pas pavarësisë, në dhjetor të vitit 1962 **Maroku** shpalli kushtetutën e vet të parë. Sipas kësaj kushtetute, u krijua një gjykatë supreme, në kuadër të së cilës u themelua një dhomë speciale me kompetencë për të vendosur lidhur me kontrollin preventiv të kushtetutshmërisë së ligjeve organike, kontrollin preventiv të rregullave të procedurës së parlamentit maroken para zbatimit të tyre, kushtetutshmërinë e zgjedhjes së anëtarëve të parlamentit maroken dhe, së fundi, lidhur me kushtetutshmërinë e referendumit.[67]

Dy kanë qenë agjendat që kanë dominuar fushatën e referendumit për miratimin e Kushtetutës **s**ë vitit 1962: një, se **Ulema**-ja duhet ta shohë çdo dispozitë kushtetuese para se të miratohet; dhe, dy, se mbreti ngelet emir (udhëheqës) i besimtarëve. Vetëm kjo e dyta gjeti vend në nenin 19 të Kushtetutës, mirëpo jo si një urdhër kushtetues: roli i mbretit si emir i besimtarëve sipas Kushtetutës nuk nënkuptonte krijimin

---

65 Për tekstin e plotë të Traktatit në mes të **Francës** dhe **Spanjës** lidhur me **Marokon**, shih në *The American Journal of International Law* Vol. 7, No. 2, Supplement: Official Documents (Apr., 1913), fq. 81-99; Për komentet e këtij traktati si dhe për historinë e tij, i cili ka qenë formalisht në fuqi deri me pavarësimin e këtij vendi më 1956, shih më shumë në: John Damis, "Developments in Morocco under the French Protectorate, 1925-1943" *Middle East Journal* Vol. 24 No. 1 (Winter, 1970), fq. 74-86.

66 George Joffe, "Morocco: Monarchy, Legitimacy and Succession", fq. 206-207, 218; Për lindjen e lëvizjes nacionaliste marokene dhe marrëdhëniet e saja me sulltanat dhe mbretërit marokenë deri në fitimin e pavarësisë së vendit, përdorimin nga nacionalistët të mbretit si mënyrë legjitimimi të nacionalizmit ndër masat urbane dhe në mesin e fiseve berbere, të cilat kanë qenë më shumë pro franceze, shih më shumë në E. G. H. Joffé. "The Moroccan Nationalist Movement: Istiqlal, the Sultan, and the Country" *The Journal of African History* Vol. 26 No. 4, World War II and Africa (1985) fq. 289-307 në fq. 289-290.

67 Cf. nenet 100-103 të titullit X ["Mbi Dhomën Kushtetuese të Gjykatës Supreme"] të **Kushtetutës së Marokut** të vitit 1962 *LA CONSTITUTION MAROCAINE DU 7 DÉCEMBRE 1962*. Në internet: http://lof.finances.gov.ma/sites/default/files/constitution_le_17_rajab_1382_14_decembre_1962.pdf (shikuar në korrik 2017). Për komente shih më shumë në Willard A. Beling, "Some Implications of the New Constitutional Monarchy in Marocco". *Middle East Journal* Vol. 18, No. 2 (Spring, 1964), fq. 163-179 (autori thekson se referendumi për miratimin e kësaj kushtetute ishte i modelit francez, me pyetje paragjykuese të rezultatit; pastaj autori thekson së në ndërkohë që vendi kaloi nga një monarki absolute në monarki kushtetuese, në aspektin e demokracisë gjërat ndryshuar fare pak sepse familja sunduese ngeli edhe më tej e pushtetshme)

e ndonjë detyrimi për të apo organet shtetërore marokene për t'i transformuar urdhrat e fesë islame në dispozoita pozitive juridike, siç kishte ndodhur me vendet tjera islamike të diskutuara më herët në këtë kapitull.[68]

Jo vetëm kaq! Nga redaktimi i dispozitave të nenit 19 si më sipër shihet qartë se më shumë është fjala për një normë që ka të bëjë me definimin e rolit të Shefit të Shtetit në një vend me rregullim kushtetues monarkik sesa me imponimin e një detyrimi të caktuar rreth kthimit të burimeve të fesë islame në dispozita ligjore pozitive dhe pajtueshmërinë e tyre me burimet primare të Islamit, siç ka ka qenë rasti me disa vende të tjera myslimane.[69] Në këtë kuptim, ndërtimi kushtetues i **Marokut** si një monarki kushtetuese është inspiruar nga fryma e **Kushtetutës së Pestë** të gjeneralit **Sharl de Goll** (Charles de Gaulle: 1890-1970). Kjo rrethanë është reflektuar në nenin 20 ["Mbi Mbretërinë"] të Kushtetutës, gjë që në literaturë me të drejtë është vlerësuar si një ndër ngjarjet më të rëndësishme të kohës.[70]

Dispozita e nenit 20, si më sipër, më shumë ka të bëjë me rolin ndërmjetësues, pajtues dhe me rolin prej arbitri në konfliktet fisnore të mbretit në Marok, duke përdorur Islamin dhe rolin e tij prijës në kuadër të koncepteve mesjetare të sulltanatit maroken para-kolonial si faktorë për të farkëtuar unitetin nacional në shoqërinë konservative dhe fisnore marokene. Kjo ndryshe njihet edhe si sistemi **Makhzen** dhe i takon kohës para-koloniale kur mbreti (sulltani) ka mbledhur rreth vetës krejt pronarët e tokave, ushtarakët, shefat e fiseve dhe kështu me radhë për të udhëhequr sulltanatin.[71] Ti kthehemi tani zgjidhjeve kushtetuese sa i përket temës sonë, gjyqësisë kushtetuese.

Dhoma Kushtetuese në kuadër të Gjykatës Supreme të Marokut (DHKM) ka funksionuar për tridhjetë vjet me radhë, deri kur u nxor Kushtetuta e vitit 1992. Në këtë vit u krijua, sipas modelit francez, **Këshilli Kushtetues i Marokut (KKM).** Në këtë periudhë tridhjetëvjeçare, DHKM ka nxjerrë mbi 820 vendime lidhur me kontrollin kushtetues të ligjeve si dhe në materien e kontesteve kushtetuese elektorale.[72] Themelimi i **KKM,** ndërkaq, përbën një ndryshim radikal dhe transformim të organit të kontrollit kushtetues maroken, si në aspektin organizativ ashtu dhe në aspektin e kompetencave të tij.

KKM ka fituar një pavarësi të theksuar nga organizimi gjyqësor maroken, përfshirë këtu pavarësinë nga Gjykata Supreme. Me Kushtetutën e vitit 2011, aktualisht në fuqi, Maroku përfundimisht themeloi **Gjykatën Kushtetuese të Marokut** (GJKM), si një gjykatë e veçantë dhe me juridiksion të ndarë kushtetues, e modeluar sipas shembullit evropian/keslenian.[73] Përveç **GJKM**, kjo Kushtetutë ka krijuar edhe institucione të tjera demokratike, ka fuqizuar ekzekutivin nacional kundrejt mbretit, duke ia marrë një pjesë të pushtetit këtij të fundit dhe duke bërë që ai të sundojë më shumë sesa të qeverisë. Me këtë ka ndodhur transformimi i **Marokut** në një monarki kushtetuese, e para e këtij lloji në botën

---

68 Neni 19 [" Mbi Mbretërinë"] i Kushtetutës së vitit 1962:
"Mbreti është Emir i Besimtarëve, simbol i unitetit të kombit, garant i përjetësisë dhe vazhdimësisë së Shtetit, si dhe kujdeset për respektimin e Islamit dhe të Kushtetutës.
Ai është mbrojtësi i të drejtave dhe lirive të qytetarëve, grupeve sociale dhe kolektiviteteve.
Ai garanton pavarësinë e kombit dhe integritetin territorial të Mbretërisë në kufijtë e saj autentikë".

69 Dispozita e nenit 19 si më sipër, e cila i jep mbretit titullin emirit të besimtarëve, në fakt, ka qenë një titull tradicioal para-kolonial që është sanksionuar formalisht me Kushtetutë për të reflektuar marrëdhëniet e ngushtë të mbretit me institucionet dhe praktikat para-koloniale të kohës së sulltanatit maroken para okupimit evropian. Cf. Ellis George H. Joffé. "The Moroccan Nationalist Movement: Istiqlal, the Sultan, and the Country".

70 Cf. më shumë për këtë në Willard A. Beling, "Some Implications of the New Constitutional Monarchy in Morocco." *Middle East Journal*, Vol. 18, No. 2 (Spring, 1964), fq. 163-179 në fq. 170 fusnota nr. 20, 172 fusnota nr. 31 dhe 176bis.

71 George Joffe, "Morocco: Monarchy, Legitimacy and Succession", fq. 218-220 & 224-225.

72 Amina El Messaoui, "La giustizia costituzionale in Marocco". Në Luca Mezzetti (ed.), *SISTEMI E MODELLI DI GIUSTIZIA COSTITUZIONALE. TOMO II* (CEDAM: Padova, 2011) fq. 367-382 në fq. 368.

73 Cf. kreu VIII, nenet 129-134 ["Gjykata Kushtetuese"] i **Kushtetutës së Marokut** të vitit 2011. *Constitution of Morocco of 2011.* Në internet: https://www. constituteproject. org/constitution/Morocco_ 2011. pdf?lang=en (shikuar në korrik 2017).

arabe, sepse ka kufizuar dukshëm pushtetin mbretëror, duke krijuar mekanizma institucionalë për ndarjen e dhe balansimin e pushteteve, duke ua njohur grave të drejtat e barabarta, duke siguruar kushtet për pavarësinë e gjyqësorit dhe kështu me radhë.

Mbreti ka mbajtur, megjithatë, disa prerogativa të rëndësishme të pushtetit, por jo si në të kaluarën. Kjo Kushtetutë ka qenë përgjigje direkte e Mbretit Muhamedi VI, ndaj turbullirave dhe dhunës së **Pranverës Arabe**, duke i paraprirë në këtë mënyrë proceseve demokratike dhe duke i kanalizuar ato në një drejtim të duhur për të mos e lënë vendin të rrëshqasë në dhunë e trazira masive deri në luftë të armatosur, siç ndodhi atëbotë me **Bahrejnin, Egjiptin, Libinë, Jemenin, Sirinë** dhe **Tunizinë**.

Një rregull të ngjashme, të moderuar dhe me plot vizion si përgjigje ndaj **Pranverës Arabe**, e ka dhënë edhe **Jordania.**[74] Diskutimi për këto çështjet tejkalon caqet e temës sonë që diskutojmë këtu, ashtu që tani duhet t'i kthehemi temës sonë të diskutimit në kontekstin maroken duke i lënë anash aspektet tjera të këtij vendi dhe të vendeve tjera arabe. Para se ta braktisim këtë, mjafton të theksohet se, me gjithë garancionin kushtetues që siguron hapësirë të mjaftueshme për funksionim të një monarkie kushtetuese, mbreti, me t'u ulur tensionet e Pranverës Arabe, ka vazhduar avazin e tij të vjetër të kontrollit të levave të pushtetit, duke ndikuar në partitë politike të të gjitha krahëve për dobi të mbajtjes dhe forcimit të pushtetit personal sipas logjikës së vjetër.[75]

Në kuptimin teknik të fjalës, **KKM** nuk ka qenë pjesë e sistemit gjyqësor. Ai është trajtuar si një organ me juridiksion të ndarë dhe të veçantë kushtetues, vendimet e të cilit kanë pasur një vlerë absolute dhe të paapelueshme për të gjithë. Nenet 76-79 ["Këshilli Kushtetutës"] të Kushtetutës normonin pozitën e këtij organi. Kjo bëhej në paragrafin e shtatë të Kushtetutës që fliste për gjyqësorin e rregullt maroken. **KKM** ka nisur së funksionuari më 1994, me miratimin e ligjit organik që ka normuar aspektet e tij organizative dhe administrative.[76]

Nga kjo shihet qartë se në aspektin institucional, **KKM** ka pasur fizionomi evropiane/kelseniane. Kjo konfirmohet edhe në aspekte të tjera veç anës institucionale: juridiksioni i **KKM** përcaktohej me nenin 79 ["Kontrolli Kushtetues"] të Kushtetutës. Sipas këtij neni, kontrolli kushtetues që ushtrohej nga ky organ, ka qenë kontroll preventiv i ligjeve organike dhe i ligjeve të zakonshme, para shpallje së tyre. Një lloj i tillë kontrolli qe përcaktuar me qëllim të ndarjes së kompetencave legjislative dhe kompetencave të tjera rregullative të organeve të tjera kushtetuese, në rend të parë të kompetencave rregullative të qeverisë. Përveç kësaj, ky nen ka mandatuar **KKM** për të bërë kontrollin kushtetues të rregullsisë së zgjedhjeve për parlament dhe për kontrollin kushtetues të rregullsisë së mbajtjes së referendumit. Jo vetëm kaq: me ligj organik ka pasur mundësi që këtij organi t'i jepen edhe kompetenca shtesë.[77]

Nenet 132 dhe 133 ["Gjykata Kushtetuese"] të Kushtetutës së vitit 2011, normojnë juridiksionin e **GJKM**. Këtë herë juridiksioni është më i qartë dhe më i gjerë: më i qartë sepse në nenin 132 përsëritet juridiksioni i njëjtë si ai i mëhershëm të cilin e ka ushtruar **KKM** në bazë të tekstit kushtetues dhe ligjeve organike të kohës, kurse më i gjerë për faktin se neni në vijim, neni 133, në paragrafin e vet të parë përcakton ushtrimin e funksionit të **kontrollit kushtetues incidental** në rastet kur një gjë e tillë është

---

74 "Morocco approves constitutional reforms". By **the CNN Wire Staff**, July 1, 2011 -- Updated 2353 GMT (0753 HKT). Në internet: http://edition.cnn.com/2011 /ËORLD/ africa /07/01/ morocco. vote.reforms/ (shikuar në korrik 2011).

75 Bertelsmann Stiftung, BTI 2016 — Morocco Country Report. Gütersloh: Bertelsmann Stiftung, 2016. Në internet: https:// www.bti-project.org/fileadmin/files/BTI/Doënloads/Reports/2016/pdf/BTI_2016_ Morocco.pdf (shikuar në korrik 2017); Adel Abdel Ghafar and Anna L. Jacobs, "Marocco: The King's Dilemma". MARAKAZ Thursday, March 2, 2017. Në internet: https://www.brookings.edu/blog/markaz/2017/03/02/morocco-the-kings-dilemma/ (shikuar në korrik 2017) ; "Freedom in the World 2017: Marocco". FREEDOM HOUSE REPORT 2017. Në internet: https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2017/morocco (shikuar në korrik 2017).

76 Amina El Messaoui, "La giustizia costituzionale in Marocco", fq. 372-373.

77 Për kompetencat shtesë që kanë të bëjnë me, ta zëmë, humbjen dhe fitimin e mandatit parlamentar, përcaktimin se cilat funksione janë të papajtueshme me pozitën e ligjvënësit, humbjen e një funksioni të tillë të ligjvënësit si pasojë e konfliktit të interesit, dhe kështu me radhë, shih në Ibid. fq. 376-377.

ngritur nga palët në një proces të ri konkret gjyqësor. Paragrafi i dytë i të njëjtit nen përcakton se një ligj organik do të bëjë implementimin e procedurave lidhur me kontrollin incidental dhe mënyrën e referimit të tij pranë **GJKM**.

Në **Tunizi**, gjyqësia kushtetuese ka kaluar nëpër dy faza të zhvillimit. Ky vend, njëjtë si Algjeria, siç u konstatua më sipër, nuk ka pasur ndonjë vazhdimësi institucionale të praktikave tradicionale para-koloniale. Zhvillimi kushtetues dhe politik tunizian ka një shkëputje me të kaluarën para-koloniale dhe është modeluar nën ndikimin e fortë evropian kolonial, shumë më shumë se në rastin algjerian. Në lëmin kushtetues, siç u pa më herët, ky nuk ka qenë rasti me **Marokun** ku traditat, praktikat dhe institucionet para-koloniale një kohë të gjatë kanë pasur ndikim në organizimin dhe ushtrimin e pushtetit.

Deri me shpalljen e pavarësisë dhe nxjerrjen e Kushtetutës së vitit 1959, kur nis faza e dytë në zhvillimin e gjyqësisë kushtetuese tuniziane në kuptimin modern të kësaj fjale, në këtë vend kanë ekzistuar disa tekste kushtetuese të rëndësishme që kanë përcaktuar kuadrin dhe rregullat e lojës politike dhe të organizimit të pushtetit. I pari ndër to, ai që do të shpie në nxjerrjen e kushtetutës së parë të shkruar në botën arabe më 1861, ka qenë **Pakti Fundamental** i vitit 1857, i nxjerrë nën presionin francez dhe britanik me qëllim të sigurimit të interesave të tyre komerciale në vend.[78] Ky dokument largoi skllavërinë, garantoi jetën dhe pronën e individit, barazinë në tatim (duke eliminuar tatimet e bazuara në Islam), njohu lirinë e fesë, barazinë para ligjit, të drejtën e të huajve për të pasur pronë dhe biznes, të drejtën e tyre për të gjykuar rastet e tyre në gjykata të veçanta dhe të ndara nga gjykatat vendore dhe kështu me radhë. Në sferën e gjyqësisë kushtetuese, ky dokument nuk ka sjellë ndonjë risi meqë fare nuk e ka njohur këtë aspekt të jetë kushtetuese.

Menjëherë pas miratimit të këtij dokumenti, në **Tunizi** u themelua një komision kushtetues për të nxjerrë një kushtetutë të vërtetë nacionale. Kjo u bë në vitin 1861, kur u nxor kushtetuta e parë e shkruar në një vend arab. Sipas shprehjes së përdorur në nenin 60.1 të Kushtetutës, **Këshilli Suprem** paraqitet "[...] si gardian i Paktit Themelor dhe ligjeve, mbrojtës i të drejtave të shtetasve. Ai kundërshton shpalljen e ligjeve të cilat bien ndesh apo që cenojnë parimet e ligjit". Shprehja e fundit që flet për ligjet, "të cilat bien ndesh apo që cenojnë parimet e ligjit", duhet të kuptohet ashtu që fjala ka qenë për tekstin e Kushtetutës së vitit 1861 dhe ligjet e aktet e tjera juridike të nxjerra në bazë të asaj Kushtetute.[79] Në literaturë është vërejtur se Kushtetuat e vitit 1861 nuk i ka kushtuar ndonjë rëndësi Islamit, aq sa edhe vetë sundimtari i Tunizisë jo domosdo është dashur të jetë i fesë islame. Autorësia për këtë Kushtetutë dhe dispozitat e saj liberale jo vetëm sa i përket rolit dhe pozitës së Islamit, por edhe ndaj të huajve, i atribuohet **Khayr al-Din** (**Hayreddin Pasha**: 1820-1890), vezirit të mëvonshëm otoman.[80]

Pas fitimit të pavarësisë në vitin 1956, tri vjet më vonë u nxor **Kushtetuta e Tunizisë** (1959). Kjo kushtetutë sanksiononte një sistem presidencial dhe nuk fliste fare për gjyqësinë kushtetuese. Në literaturë është vërejtur se çështja e gjyqësisë kushtetuese as që ka qenë e zënë në gojë në kohën e përgatitjes së kësaj kushtetuese.[81] Sipas nenit 41.1 ["Kapitulli III. Pushteti Ekzekutiv: Presidenti"] të Kushtetutës, Presidenti paraqitej si garantues i zbatimit të Kushtetutës, ligjeve dhe ekzekutimit të traktateve ndërkombëtare. Një projektligj për amendamentim të Kushtetutës i datës 9 shkurt 1971, ka përmendur, për herë të parë, mundësinë e krijimit të një këshilli kushtetues sipas modelit francez, i cili do të ishte kompetent për kontrollin preventiv të ligjeve organike, ligjeve të zakonshme dhe të rregulloreve të punës së parlamentit. Ky propozim u la në harresë deri në vitin 1987. Më 16 dhjetor të këtij viti u nxor **Dekreti nr. 87 – 1415,** me të cilin themelohej organi konsultativ i cilësuar si **Këshilli Kushtetues** (KKT). Me këtë dekret, Pres-

[78] Fatemah Alzubairi, *Colonialism, Neo-Colonialism, and Anti-Terrorism Law in the Arab World* (Cambridge University Press: Cambridge, 2019) fq. 164.

[79] Cf. Neni 60.1 i kapitulli VII ["Mbi Autorizimet e Këshillit Suprem"] të Kushtetutës së 28 prillit 1861. *Constitution du 26 avril 1861*. Në internet: http://mjp.univ-perp.fr/constit/tn1861.htm (shikuar në korrik 2017).

[80] Alfred Stepan, "Tunisia's Transition and the "Twin Tolerations". Në Larry Diamond, Marc F. Plattner (eds.), *Democratization and Authoritarianism in the Arab World* (John Hopkins University Press: Baltimore, 2014) fq. 218-232 në fq. 227-228.

[81] Rafaâ Ben Achour, "La Constitution tunisienne du 27 janvier 2014." *Revue française de droit constitutionnel,* fq.797.

identi i Republikës ishte pala e vetme që mund ta vinte në lëvizje **KKT.** Kjo për shkak se, sipas nenit 41 si më sipër, Presidenti akoma cilësohej si garantuesi i respektimit të Kushtetutës, ligjeve dhe ekzekutimit të traktateve. Në këtë kontekst, **KKT** e ndihmonte Presidentin në ushtrimin e funksioneve si më sipër. Kontrolli i ligjeve ishte preventiv, kurse vendimet e **KKT** kishin natyrë konsultative.

Në vitin 1995, ka pasur amendamentime të Kushtetutës së vitit 1959, me të cilat është përmirësuar pozita e KKT, vendimet e të cilit tani e tutje kishin efekt **erga omnes**. Ky organ ka funksionuar deri në revolucionin e vitit 2011: **Pranvera Arabe** në **Tunizi** pati një sukses të jashtëzakonshëm për faktin se ky vend, nga një diktaturë presidenciale, u shndërrua në një demokraci kushtetuese parlamentare me elemente semi-presidenciale.[82] Tani pushtetet janë të ndara, ka sundim të ligjit dhe liritë dhe të drejtat individuale në mënyrë relativisht të qartë garantohen me Kushtetutë.[83] Kjo, megjithatë, nuk ndodhi për një natë. U deshën disa vite, derisa më 2014, u nxor kushtetuta e re, e cila aktualisht është në fuqi.

Në periudhën prej vitit 2011 deri më 2014, kanë funksionuar disa organe kalimtare të pushtetit, në mesin e tyre edhe një këshill kalimtar për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve, gjithnjë duke qenë fjala për kontrollin preventiv të draft-ligjeve, pra të ligjeve të cilat votohen në parlament, por që akoma nuk kanë marrë shpalljen. Kompetencat tjera, siç është kontrolli kushtetues i rregullave të procedurës së parlamentit tunizian, zgjidhja e konfliktit për kompetencë dhe kështu me radhë, nuk mund të ushtroheshin nga ky organ i përkohshëm dhe kalimtar.[84] Këto kompetenca u la që të ushtrohen nga një tjetër organ i themeluar me Kushtetutën e vitit 2014.[85]Ai organ ishte **GJKTZ.**

Sipas Kushtetutës, në mënyrë të çuditshme, ky organ u radhit në kuadër të sistemit gjyqësor tunizian: pjesa e dytë e kapitullit të pestë të Kushtetutës, në shtatë nene flet për përbërjen, kompetencat, efektet e jokushtetutshmërisë të konstatuara me vendim, afatet kohore për vendimmarrje etj. Para se të flasim në detaje për këtë organ të ri, këtu duhet të shënojmë për lexuesin se, me gjithë këto risi dhe prurje të reja kushtetuese, të panjohura deri atëherë në vend, zhvillimet kushtetuese revolutive dhe radikale që ndodhën, nuk u reflektuan në preambulën e Kushtetutës apo në ndonjë dispozitë tjetër të saj. Këtë rrethanë me të drejtë e ka vërejtur **Komisioni i Venecias** më 2013, gjatë kryerjes së "kontrollit kushtetues intelektual" të draftit të saj.[86]

Neni 118 i ["Pjesa e Dytë: Gjykata Kushtetuese"] i Kushtetutës përcakton cilësitë themelore dhe përbërjen e **GJKTZ**. Në rend të parë, ky nen flet për pavarësinë e këtij organi dhe natyrën e saj si një organizëm juridiksional. Nga kjo dalin dy cilësi. E para, siç u tha më sipër, **GJKTZ** trajtohet si pjesë e pushtetit

---

82 EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (Venice Commission), *OPINION 733 OF OCTOBER 2013 ON THE FINAL DRAFT CONSTITUTION OF THE REPUBLIC OF TUNISIA*. Adopted by the Venice Commission at its 96th Plenary Session (Venice, 11-12 October 2013). CDL-AD(2013) 032 Or. fr. (Strasbourg, 17 October 2013), paragrafet 78-81 ["Legjislatura"].

83 Për zhvillimet në Tunizi pas ngjarjeve revolutive të janarit të vitit 2011, shih më shumë në Rafaâ Ben Achour, Sana Ben Achour, "LA TRANSITION DÉMOCRATIQUE EN TUNISIE: ENTRE LÉGALITÉ CONSTITUTIONNELLE ET LÉGITIMITÉ RÉVOLUTIONNAIRE". *Revue française de droit constitutionnel* Vol. 4 No. 92 (2012) fq. 715- 732 (autori diskuton tri faza të këtij zhvillimi pas vitit 2011: faza e parë, "faza kushtetuese ", faza e dytë, "faza konsensuale" dhe, së fundi, faza e tretë "faza demokratike" ; autori po ashtu jep në mënyrë të detajuar aktivitetin e dendur të Asamblesë Kushtetuese, e cila luajti një rol të madh në draftimin e kushtetutës aktuale të Tunizisë dhe në kalimin e qetë të këtij vendi nga një diktaturë presidenciale në një sistem demokratik kushtetues).

84 Ibid. fq. 798-799 ; **KKT** nuk mund të cilësohet si një organ i kontrollit kushtetues juridiksional në kuptimin e sotëm të fjalës për dy arsye: *e para*, sepse kontrolli kushtetues (preventiv) i normave juridike, si detyrë primare e tij, bëhej vetëm sipas kërkesës së Presidentit të Republikës ; dhe, *e dyta*, efekti i kufizuar juridik i vendimeve të këtij organi. Shumë vonë ky organ u cilësua si i detyrueshëm për t'u këshilluar, kurse vendimet e tij kohën më të madhe nuk kanë gëzuar efekt **erga omnes**. Organi me juridiksion kushtetues me detyrë për të ushtruar kontroll preventiv të kushtetutshmërinë së normave ligjore dhe traktateve e marrëveshjeve ndërkombëtare me një efekt **erga omnes** u krijua vetëm me **Kushtetutën e Tunizisë** të 27 janarit 2014. Vlen të theksohet se, pikërisht për këto arsye, ky organ, **Gykata Kushtetuese e Tunizisë** (GJKTZ), nuk mund të konsiderohet si vazhdimësi e KKT sepse paraqet një risi krejtësisht të ndryshme për sistemin kushtetues tunizian.

85 *Tunisie. Constitution du 27 janvier 2014.* Në internet: http://mjp.univ-perp.fr/constit/tn2014.htm#5 (shikuar në korrik 2017).

86 EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (Venice Commission), *OPINION 733 OF OCTOBER 2013 ON THE FINAL DRAFT CONSTITUTION OF THE REPUBLIC OF TUNISIA*. paragrafi 7.

gjyqësor. Kjo cilësi e bën të dallueshëm nga pararendësi i tij, **KKT**, i cili ka qenë i lidhur kryesisht me pushtetin ekzekutiv dhe ka ndihmuar shefin e shtetit si ekzekutiv për të ushtruar funksionon e tij primar të garantuesit të zbatimit të Kushtetutës, ligjeve dhe traktateve ndërkombëtare. Kjo reflektohet edhe në natyrën juridike të vendimeve të saj: **GJKTZ** tani jep vendime juridiksionale, jo më "mendime", siç bënte dikur **KKT.**

Cilësia e dytë është e brendshme dhe ka të bëjë me pushtetin gjyqësor si të tillë. Nuk ka asnjë juridiksion tjetër mbi **GJKTZ** sepse, siç e thotë fjalia e parë e nenit 120 ["Pjesa e Dytë: Gjykata Kushtetuese "] të Kushtetutës, vetëm ajo ka monopolin e kontrollit të kushtetutshmërisë. Me këtë monopol natyrshëm shkon edhe dispozita tjetër e Kushtetutës që thekson se vendimet e saj janë të detyrueshme për të gjitha autoritetet publike.[87] Këto tri aspekte e bëjnë të kontestueshme radhitjen në mënyrë të çuditshme të këtij organi në kuadër të sistemit gjyqësor tunizian.[88]

Neni 118 i Kushtetutës, po ashtu flet edhe për numrin e gjyqtarëve dhe mënyrën e zgjedhjes së tyre, çështje që ne nuk e diskutojmë me këtë rast. Kjo sepse këtë nuk e kemi bërë as me rastet tjera sepse fokus i ynë ekskluzivisht ka të bëj me gjyqësinë kushtetuese, formën dhe përmbajtjen e saj, krahas zhvillimit historik të këtij fenomeni modern.

Neni 120.1 ["Pjesa e Dytë: Gjykata Kushtetuese"] i Kushtetutës është një ndër nenet kryesore të këtij institucioni të ri tunizian. Ky nen i jep në gjashtë fusha kompetencë ekskluzive Gjykatës Kushtetuese. Në fakt, janë pesë fusha sepse në paragrafin e dytë të këtij neni, ku thuhet se në përgjegjësi të **GJKTZ** do të jenë edhe disa detyra të tjera. Këto detyra, megjithatë, nuk janë të natyrës juridiksionale.

Kompetenca e parë e **GJKTZ** konsiston në kontrollin preventiv kushtetues të draft-ligjeve të miratuara nga parlamenti. Kjo procedurë tani mund të vihet në lëvizje, përveç nga presidenti si gardian i Kushtetutës,[89] edhe nga tridhjetë anëtarë të parlamentit. Kjo dispozitë është shqyrtuar dhe vlerësuar lartë nga **Komisioni i Venecias.**[90]

Kompetenca e dytë e **GJKTZ** është më specifike dhe ka të bëjë me amendamentet kushtetuese, pra me kontrollin preventiv kushtetues të amendamenteve të propozuara kushtetuese. Sipas nenit 144.1 ["Amendamnetimi i Kushtetutës"] të Kushtetutës, **GJKTZ** në një rast të tillë bën një kontroll të dyfishtë të kushtetutshmërisë. Në njërën anë, ajo duhet të shikojë nëse amendamentet e propozuara shkelin (cenojnë) ndonjërën prej dispozitave kushtetuese që nuk mund të amendamentohen fare. Kjo ka të bëjë me kontrollin material (substancial) të kushtetutshmëirsë së amendamenteve të propozuara. Dispozita të natyrës së tillë janë nenet 1 dhe 2 ["Parimet e Përgjithshme"] të Kushtetutës: neni i parë përcakton **Tunizinë** si një shtet islamik, arab, me gjuhë arabe dhe rregullim shtetëror republikan, kurse neni i dytë, në mënyrë të çuditshme dhe kundërthënëse me nenin paraprak, thotë se **Tunizia** është shtet qytetar, i cili bazohet në vullnetin e popullit dhe sundimin e ligjit.[91] Në dy këto nene, në paragrafin e fundit,

---

87 Cf. Neni 121.1 ["Pjesa e Dytë: Gjykata Kushtetuese"] i Kushtetutës: "[...] Vendimet e dhëna nga Gjykata Kushtetuese duhet të jenë të arsyetuara, të detyruehme për të gjitha autoritetet dhe të publikuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Tunizisë [...]"

88 Cf. Nenet 102- 124 të kapitullit të pestë ["Autoriteti Gjyqësor"] të Kushtetutës.

89 Cf. Neni 72 ["Pjesa e Parë: Presidenti i Republikës"] i Kushtetutës: "Presidenti i republikës është Kreu i Shtetit dhe simboli i imunitetit të tij. Ai garanton pavarësinë dhe kontinuitetin e tij, si dhe siguron respektimin e Kushtetutës".

90 Cf. më shumë për këtë në në EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (Venice Commission), *OPINION 733 OF OCTOBER 2013 ON THE FINAL DRAFT CONSTITUTION OF THE REPUBLIC OF TUNISIA,* paragrafi 175.

91 Në versionin e vitit 2013, i cili është kontrolluar nga **Komisioni i Venecias**, liria e fesë është nënkuptuar si lira e fesë islame dhe dominimi i kësaj feje kundrejt feve tjera. Pas vërejtjeve të Komisionit për të bërë modifikime dhe saktësime gjuhësore ashtu që të bëhet e qartë që Tunizia mbron edhe lirinë e feve dhe besimeve tjera, Kushtetuta e vitit 2014, ka inkorporuar një gjuhë më neutrale dhe më të moderuar, në fakt një gjuhë që është vërtet e arritur për tërë botën islamike sepse ka futur në tekst zgjidhje kushtetuese që garantojnë barazinë e të gjithë në çështjet e fesë dhe mosdiskriminim në jetën publike si pasojë e mosqenies anëtar i fesë dominante, Islamit, në këtë vend. Cf. më shumë për këtë në EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (Venice Commission), *OPINION 733 OF OCTOBER 2013 ON THE FINAL DRAFT CONSTITUTION OF THE REPUBLIC OF TUNISIA,* paragrafët 27-37 ["The State and Religion"].

ekziston një dispozitë e njëjtë, e cila në mënyrë shprehëse thekson se nenet në fjalë nuk mund të amendamentohen.

Në anën tjetër, **GJKTZ ë**shtë e autorizuar për të bërë kontrollin e kushtetutshmërisë së amendamenteve të propozuara kushtetuese për sa i përket anës së tyre procedurale. Sikundër mund të vërehet, kontrolli material (substancial) dhe kontrolli procedural i amendamenteve të propozuara kushtetuese është i ngjashëm me rastin e **Kosovës**. Për këtë do të shihet më vonë kur të flasim për juridiksionin dhe palët e autorizuara sipas Kushtetutës së Kosovës (kapitulli njëmbëdhjetë).

Në draftin e vitit 2013 të Kushtetutës, e cila është kritikuar nga **Komisioni i Venecias**, iniciativa për ndryshim të Kushtetutës i ka takuar vetëm presidentit të republikës. Kjo zgjidhje kushtetuese është ndryshuar: sot, sipas nenit 143 ["Amendamentimi i Kushtetutës"] të Kushtetutës, krahas presidentit iniciativa për ndryshim i takon edhe deputetëve, përkatësisht një të tretës së anëtarëve të **Asamblesë së Përfaqësuesve të Popullit** (siç quhet parlamenti tunizian). Kjo do të thotë se, sikur në rastin e **Kosovës**, iniciativa për amendamentim kushtetues nuk barazohet me autorizimin formal të kryetarit të parlamentit për të referuar draft-amendamentet për kontroll kushtetues në gjykatën nacionale kushtetuese. Këto janë dy çështje krejtësisht të ndryshme dhe të ndara sepse kryetari i parlamentit tunizian është vetëm referues që nuk mund të pengojë iniciativën për ndryshim kushtetues.[92]

Kompetenca e tretë ka të bëjë me kontrollin kushtetues të traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare. Sipas nenit 20 ["Parimet e Përgjithshme"] të Kushtetutës, traktatet dhe marrëveshjet ndërkombëtare kanë forcë juridike më të lartë se ligji, por më të ulët se Kushtetuta. Fjala është për traktatet dhe marrëveshjet e ratifikuara.

Për dallim nga Kosova, **GJKTZ** ka autorizim për të bërë kontrollin kushtetues preventiv të traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, pra para miratimit dhe ratifikimit të tyre nga parlamenti. Ky nen përdor dy fjalë: fjalën "miratim" dhe fjalën "ratifikim". Kjo ka dallim të madh, përfshirë dhe rastin e Kosovës. Kjo për arsye se ekzistojnë marrëveshje ndërkombëtare që ratifikohen nga shefi i shtetit, kryeministri apo ministri i jashtëm, kurse organi përfaqësues (parlamenti) vetëm informohet për to sepse janë në kompetencë të këtyre tri organeve shtetërore. Në anën tjetër, ka traktate dhe marrëveshje ndërkombëtare që nuk mund të ratifikohen nga tri organet si më sipër dhe për to kërkohet ratifikim parlamentar. Kjo bëhet përmes nxjerrjes së një ligji për ratifikim, nisur nga fakti se të njëjtat nuk bien brenda fushës së veprimit dhe punës së tri organeve kushtetuese si më sipër. Të një natyre të tillë janë marrëveshjet për territorin dhe sovranitetin, për futjen e shtetit në borxh, marrëveshjet politike për aleanca me shtetet apo organizata tjera dhe kështu me radhë. Këtë zgjidhje kushtetues e ka edhe **Kosova** në nenin 18.1 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës.

Përveç kësaj, për dallim nga Kosova, **Kushtetuta e Tunizisë** nuk flet fare për statusin juridik të burimeve të tjera të së drejtës ndërkombëtare që nuk janë e drejtë e traktateve, përkatësisht për statusin e të drejtës ndërkombëtare zakonore, parimeve të përgjithshme të drejtës ndërkombëtare, si dhe të instrumenteve kryesore ndërkombëtare mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Kjo temë, e cila ka qenë objekt i kritikës së **Komisionit të Venecias**, megjithatë, tejkalon caqet e diskutimit tonë në këtë libër.[93]

Kompetenca e katërt përfaqëson një risi të madhe për **Tunizinë**. Kjo i lejon **GJKTZ** që të bëjë kontrollin represiv, **a posteriori**, të kushtetutshmërisë së ligjeve, por vetëm sipas një kërkese të dërguar nga gjykatat e rregullta me iniciativën e palëve. Fjala është për **kontrollin incidental**. Kushtetuta përdor fjalën "prapësim i kushtetutshmërisë", nga gjuha frënge "exception d'inconstitutionalite". Mirëpo, kup-

---

92 Cf. më shumë për vërejtjet e Komisionit sa i përket palëve të autorizuara për të referuar rastin në Gjykatën Kushtetuese të Tunizisë, në EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (Venice Commission), *OPINION 733 OF OCTOBER 2013 ON THE FINAL DRAFT CONSTITUTION OF THE REPUBLIC OF TUNISIA,* paragrafët 175-176.

93 Cf. më shumë për këtë në në EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (Venice Commission), *OPINION 733 OF OCTOBER 2013 ON THE FINAL DRAFT CONSTITUTION OF THE REPUBLIC OF TUNISIA,* paragrafi 40.

timi i dispozitës është i qartë: gjyqtari apo gjykata pranë së cilës është duke u zhvilluar një procedurë gjyqësore lidhur me një rast apo mosmarrëveshje, duhet ta referojë çështjen në **GJKTZ** çdoherë kur dyshon se ligji apo norma që duhet të zbatohet në një rast apo mosmarrëveshje të tillë ka cilësi të normës jokushtetuese. Kjo nga fakti i thjeshtë se vetëm **GJKTZ** ka monopolin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së normave dhe dispozitave juridike, kurse organet tjera detyrohen ta zbatojnë Kushtetutën dhe ligjet, por jo t'i interpretojnë ato me efekt **erga omnes** dhe përfundimtar. Kjo është cilësi bazike e juridiksionit të ndarë kushtetues që ushtrohet nga një gjykatë e veçantë kushtetuese (modeli evropian/kelsenian).

Kompetenca e pestë dhe e fundit e përcaktuar në nenin 20 si më sipër ka të bëjë me kontrollin kushtetues të rregullave të brendshme të parlamentit tunizian. Nga gjuha e përdorur mund të përfundohet se këtu bëhet fjalë për kontroll të detyrueshëm të kushtetutshmërisë së rregullave të brendshme të parlamentit dhe të çdo ndryshimi që ato mund të pasojnë pas nxjerrjes së tyre për herë të parë.

Fare në fund, vlen të theksohet se, sipas rekomandimit të **Komisionit të Venecias**, rregullat që normojnë organizimin e **GJKTZ**, procedurat që duhen ndjekur në gjykimet pranë saj, si dhe garanconet që duhet t'i gëzojnë gjyqtarët, janë të përcaktuara me një ligj institucional.[94]

Në **Tunizi** ekziston një ligj organik (institucional) me të cilin definohen gjërat si më sipër.[95] Edhe ky ligj ka qenë objekt i "kontrollit kushtetues intelektual" nga ana e **Komisionit të Venecias.**[96] **Ligji Organik Nr. 2015-50 mbi Gjykatën Kushtetuese të Tunizisë** i datës 3 dhjetor 2015, në titull ndryshon nga ai që ka qenë objekt vlerësimi në **Komisionin e Venecias**, por esenca e tij ngelet e njëjtë: me këtë ligj implementohen dispozitat kushtetuese që normojnë organizimin e **GJKTZ**, procedurat që duhen ndjekur në gjykimet pranë saj, si dhe garancionet që duhet t'i gëzojnë gjyqtarët, janë të përcaktuara me një ligj institucional.

Ligji ka sjellë dy risi. *E para*, në nenin e parë ["Dispozitat e Përgjithshme"], në mënyrë të shkëlqyeshme, shumë më saktë se në tekstin kushtetues, definohet fizionomia e **GJKTZ**: ajo, thuhet në këtë nen, përbën një instancë të pavarur me juridiksion për të garantuar supremacinë (epërsinë) e Kushtetutës, si një mbrojtëse e sistemit demokratik dhe i lirive dhe të drejtave njerëzore, në kuadër të prerogativave dhe kompetencave të parapara me Kushtetutë dhe të shpallura me këtë ligj. *E dyta* risi ka të bëjë me faktin se Ligji ka edhe dispozita shtesë lidhur me kompetencat e **GJKTZ** të cilat nuk hasen në Kushtetutë. Ato kompetenca shtesë përcaktohen në nenet 65-76 ["Mbi Procedurat që kanë të bëjnë me Misionet tjera të Gjykatës"] të Ligjit. Këto kompetenca shtesë, në seksionin e gjashtë të këtij kapitulli, cilësohen si procedura shtesë që kanë të bëjnë me misionin e **GJKTZ**. Në to hyjnë: shkarkimi i Presidentit të Republikës për shkak të shkeljeve të rënda të Kushtetutës (nenet 65-68); konstatimi i postit vakant të Presidentit të Republikës (nenet 69-70) ; betimi i ushtruesit të detyrës të Presidentit të Republikës (neni 71); vazhdimi i gjendjes së jashtëzakonshme (nenet 72-73); dhe, së fundi, konflikti për kompetencë në mes të Presidentit dhe Shefit të Qeverisë (nenet 74-76).

7.5. Komente dhe pyetje

7.5.1. Cilësi e përbashkët e konstitucionalizmit të vendeve islamike është, në parim, se ato si parametër matës të tij nuk e kanë supremacinë (epërsinë) e kushtetutës nacionale. Çka marrin për bazë si parametër për promovimin e versionit të tyre islamik të konstitucionalizmit dhe si dallon ai nga konstitucionalizmi perëndimor?

---

94 EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (Venice Commission), *OPINION 733 OF OCTOBER 2013 ON THE FINAL DRAFT CONSTITUTION OF THE REPUBLIC OF TUNISIA,* paragrafi 182.

95 *Loi organique n° 2015-50 du 3 décembre 2015, relative à la Cour constitutionnelle.* Në internet: http://www.legislation.tn/sites/default/files/fraction-journal-officiel/2015/2015F/098/Tf2015501.pdf (shikuar në korrik 2017).

96 EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (Venice Commission), *OPINION NO. 817/2015 OF 26 OCTOBER 2015 ON THE DRAFT INSTITUTIONAL LAW ON THE CONSTITUTIONAL COURT OF TUNISIA.* Adopted by the Venice Commission at its 104th Plenary Session (Venice, 23-24 October 2015). CDL-AD (2015) 024 Or. fr. (Strasbourg, 26 October 2015).

7.5.2. Vendi më teokratik i versionit **Suni të Islamit** është **Arabia Saudite**. Kjo është kështu sepse, për dallim nga **Irani**, ky vend ka një regjim monarkik dhe një qeverisje tërësisht jodemokratike, e cila fare nuk bazohet në testimin e vullnetit të votuesve, qoftë edhe në ndonjë prej formave fiktive të testimit. Në këtë vend ekzistojnë një tufë ligjesh themelore, tri sosh, të integruara në një tekst të vetëm. Vetëm në aspektin formal ato ligje mund të cilësohen si kushtetutë. Diskutoni!

7.5.3. Kjo rrethanë, pra mospasja e një trupi përfaqësues në këtë vend, si dhe mungesa e rolit të gjyqësorit për kontrollin e veprimit politik të organeve shtetërore, përfshirë këtu rolin e gjyqësorit në kontrollin kushtetues të ligjeve, bëhet edhe më e qartë nëse kihet parasysh roli kushtetues, pozita dhe juridiksioni i **Këshilli Shura,** një praktikë e nisur me **Kuranin** dhe që ka pasur një ndikim të madh në kulturën dhe historinë arabe. Çfarë do të thotë kjo?

7. 5.4. Cili është roli i gjyqësorit të **Arabinë Saudite** dhe çfarë roli dhe pozite në këtë vend ka **Këshilli i Shuras**?

7.5.5. Ekzistojnë disa cilësi të kontrollit kushtetues në Egjipt që e bëjnë këtë vend të ndryshëm nga Arabia Saudite dhe Irani. Kjo vërehet në veçanti në aspektin institucional, por edhe në aspektin historik. Për çfarë bëhet fjalë këtu? Diskutoni!

7.5.6. Në **Kushtetutën e Egjiptit** ekziston një dispozitë që autorizon **GJSKE** për të shikuar nëse ligjet e vendit bien ndesh me të **Drejtën e Sheriatit**. E kemi fjalën për nenin 2 të Kushtetutës. Kjo gjendje, megjithatë, nuk duket kështu në jurisprudencën e **GJSKE.** Ky organ ka bërë një interpretim tjetër lidhur me rolin dhe pozitën e të **Drejtës së Sheriatit**. Kjo ka një histori që lidhet me vetë historinë e nenit 2 si më sipër. Diskutoni këtë histori dhe shpjegoni arsyet për këtë jurisprudencë ndryshe të **GJSKE**!

7.5.7. Konstitucionalizmi në **Iran** nis me Kushtetutën e viti 1876 të sulltanit **Abdyl Hamitit**. Ani se ajo kushtetutë nuk pati jetë të gjatë, vetëm dy vjet, efekti i saj rrezatues në Iran (por edhe vendet tjera islamike) ka vazhduar deri në kapërcyell të shekullit XX për t'u kurorëzuar më 1906 me kushtetutën e parë të këtij vendi. Deri në revolucionin islamik të vitit 1979, u nxorën disa kushtetuta iraniane. A kanë parashikuar ndonjëra prej tyre kontroll kushtetues përmes mekanizmave gjyqësorë apo kontroll politik të kushtetutshmërisë?

7.5.8. Që nga nxjerrja e Kushtetutës së parë të Irannit në vitin 1906, në këtë vend kanë ekzistuar paralelisht dy sisteme juridike, njëri fetar dhe tjetri laik. Kjo bashkëjetesë i këtyre dy rendeve juridike ka jetuar deri në vitin 1979. Si janë interpretuar burimet e njërit dhe si të tjetrit rend juridik? Kush e ka bërë interpretimin e tyre?

7.5.9. Në **Iranin** e pas vitit 1979 ekziston një rend kushtetues që bazohet në një hierarki tjetër të burimeve të së drejtës, krahasuar me sistemet e mëhershme kushtetuese. Tani e tutje as që mund të bëhet fjalë për epërsi (supremaci) të Kushtetutës së vitit 1979 kundrejt Kuranit dhe burimeve të tjera të **Islamit Shia**. Për çfarë bëhet fjalë këtu? Cilin status e ka Kushtetuta në kuptim të kontrollit të saj gjyqësor?

7.5.10. Sipas nenit 4 të Kushtetutës së vitit 1979, jo vetëm ligjet dhe aktet tjera juridike, por edhe secili nen i saj duhet të jetë në pajtim të plotë me parametrat e Islamit. Juristët e jurisprudencës (**fuqaha**) dhe të drejtës islamike (**fiqh**) që përbëjnë **Këshillin e Gardianëve** janë gjyqtarë të kësaj çështjeje. Çfarë do të thotë kjo? Kush e bën kontrollin kushtetues në Iran dhe çfarë natyre ka ai kontroll?

7.5.11. Irani, pas vitit 1979, ka ofruar sfidën më të ashpër dhe më serioze ndaj konstitucionalizmit modern, të bërë ndonjëherë nga një vend islamik. Diskutoni arsyet pse kjo është kështu?

7.5.12. Në **Algjeri** në fuqi është Kushtetuta e vitit 1963, e para pas pavarësimit të këtij vendi nga

Franca pas një kohe të gjatë të dominimi kolonial. Ajo ka pasur amendamentime të thella më 2002, 2008 dhe 2016. Me amendamentet e fundit në vitin 2016, u parashikua ndarja e pushtetit. Kjo ndarje, megjithatë, nuk përcaktohet sipas standardeve perëndimore. Diskutoni!

7.5.13. Nenet 182, 186, 188 dhe 190 të Kushtetutës së Algjerisë normojnë në një mënyrë çuditërisht të shkapërderdhur juridiksionin e **KKA.** Diskutoni se për çfarë juridiksioni bëhet fjalë në këto nene dhe sa ngjason ai me juridiksionin e **Këshillit Kushtetues të Francës**.

7.5.14. Sikundër shihet nga diskutimi në këtë kapitull, mjaft zgjidhje kushtetuese algjeriane janë të ngjashme me ato franceze kur flitet për kontrollin e kushtetutshmërisë. Diskuto se për çfarë ngjashmërish bëhet fjalë dhe cila është arsyeja kryesore për një ngjashmëri të tillë!

7.5.15. Pas fitimit të pavarësisë, **Maroku** ka nxjerrë kushtetutën e vet të vitit 1962. Cilat kanë qenë kompetencat e dhomës speciale marokene për kontroll kushtetues. Kjo dhomë ka funksionuar brenda Gjykatës Supreme?

7.5.16. Ndërtimi kushtetues i **Marokut** si një monarki kushtetuese është inspiruar nga fryma e **Kushtetutës së Pestë** të gjeneralit **Sharl de Goll**. Kjo rrethanë është reflektuar në nenin 20 ["Mbi Mbretërinë"] të Kushtetutës, gjë që në literaturë me të drejtë është vlerësuar si një ndër ngjarjet më të rëndësishme të kohës. Diskutoni!

7.5.17. Si në aspektin institucional ashtu edhe të juridiksionit, **KKM** ka pasur fizionomi **evropiane/kelseniane**. Në veçanti në sferën juridiksionale, ky organ ka pasur shumë kompetenca interesante. Diskutoni se cilat kanë qenë kompetencat konkrete të këtij organi në materien e kontrollit kushtetues. A ka dallim në mes të juridiksionit të KKM dhe GJKM?

7.5.18. Sipas nenit 41.1 ["Kapitulli III. Pushteti Ekzekutiv: Presidenti"] të Kushtetutës së **Tunizisë** të vitit 1959, Presidenti paraqitej si garantues i zbatimit të Kushtetutës, ligjeve dhe ekzekutimit të traktateve ndërkombëtare. Një projekt-ligj për amendamentim e kësaj Kushtetute i datës 9 shkurt 1971 ka përmendur, për herë të parë, mundësinë e krijimit të një këshilli kushtetues sipas modelit francez. Ai organ do të ishte kompetent për kontrollin preventiv të ligjeve organike, ligjeve të zakonshme dhe të rregulloreve të punës së parlamentit. Ky propozim u la në harresë deri në vitin 1987. Më 16 dhjetor të këtij viti u nxor **Dekreti nr. 87 – 1415** me të cilin themelohej organi konsultativ i cilësuar si **Këshilli Kushtetues** (**KKT**). Me këtë dekret, Presidenti i Republikës ishte pala e vetme që mund ta vinte në lëvizje **KKT.** Pse kjo ishte kështu dhe cilit qëllim i shërbente?

7.5.19. Neni 118 i ["Pjesa e Dytë: Gjykata Kushtetuese"] i Kushtetutës së Tunizisë përcakton cilësitë themelore dhe përbërjen e **GJKTZ**. Në rend të parë, ky nen flet për pavarësinë e këtij organi dhe natyrën e saj si një organizëm juridiksional. Nga kjo dalin dy cilësi. Cilat janë ato? Diskutoni!

7.5.20. Kompetenca e dytë e **GJKTZ** është më specifike dhe ka të bëj me amendamentet kushtetuese, pra me kontrollin preventiv kushtetues të amendamenteve të propozuara kushtetuese. Sipas nenit 144.1 ["Amendamnetimi i Kushtetutës"] të Kushtetutës, **GJKTZ** në një rast të tillë bën një kontroll të dyfishtë të kushtetutshmërisë. Për çfarë bëhet fjalë këtu?

7.5.21. Tunizi ekziston një ligj organik me të cilin implementohen dispozitat kushtetuese që normojnë organizimin e **GJKTZ**, procedurat që duhen ndjekur në gjykimet pranë saj, si dhe garancionet që duhet t'i gëzojnë gjyqtarët janë të përcaktuara me një ligj institucional. Ai ligj, megjithatë, ka edhe dy risi që kalojnë përtej këtyre si më sipër. Për çfarë risish bëhet fjalë? Në veçanti diskutoni kompetencat shtesë të dhëna më këtë ligj dhe krahasoni ato me pesë kompetencat shumë të rëndësishme që ka **GJKTZ**, duke treguar dallimin në mes tyre.

7.6. Lexim shtesë

- EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION). CDL-JU (2003) 30 (Strasbourg, 18 September 2003). Report by Mr László Sólyom (Member, Hungary). Conference on "Constitutional Justice and the Rule of Law" on the occasion of the 10th anniversary of the Constitutional Court of Lithuania (Vilnius, 4-5 September 2003)
- Mark Gould, "Islam, the Law, and the Sovereignty of God". *Policy Review* No. 149 (June/July 2008)
- Nathan J. Brown, "Egypt: A Constitutional Court in an Unconstitutional Setting". A paper prepared for the constitutional transitions and global and comparative law colloquium (New York University School of Law: 23 October 2013).
- Mark Gould, "Toward a Theory of "Islamist Movements". *Sociology of Islam*, Volume 2, Issue 1-2 (2014)
- Tom Gerald Daly, "A CONSTITUTIONAL COURT FOR SRI LANKA? PERCEPTIONS, POTENTIAL & PITFALLS". *CPA Working Papers on Constitutional Reform* | No. 15, April 2017 | Në internet: Centre for Policy Alternatives | www.cpalanka.org (shikuar në korrik 2017)

8. SISTEMET TJERA (V): VENDET E CAKTUARATË AZISË DHE ARIKËS

Përgjithësisht. - Në këtë grupim të shteteve i kemi përzgjedhur disa vende bazuar në specifikat konceptuale, institucionale, ideologjike, si dhe duke u bazuar në gjeografinë e tyre dhe faktit se në këtë hapësirë mund të shkëpusim disa nga vendet që më së shumti reflektojnë mesataren e sistemeve dhe modeleve të gjyqësisë kushtetuese që diskutohen në këtë libër. Kjo nënkupton se, sikur në kapitullin pararendës, vendet e shkëputura për trajtim janë përfaqësues të një shumice në kuadër të gjeografisë kushtetuese përkatëse.

Në ndërkohë që **Lindja e Largët** paraqet një kolorit më të madh sa i përket sistemeve dhe modeleve të përqafuara të gjyqësisë kushtetuese, aq sa nuk mund të thuhet se modeli i koncentruar (centralizuar) dominon, në vendet e **Afrikës** më shumë mbizotëron sistemi i gjyqësisë kushtetuese që ka juridiksion të ndarë kushtetues dhe është i koncentruar kryesisht në pjesën frankofone të **Afrikës**. Edhe këtu ndikimi francez vihet në spikamë sepse ky juridiksion i ndarë dhe i centralizuar (koncentruar) i gjyqësisë kushtetuese, në të shumtën e rasteve, nuk është represiv por preventiv dhe nuk ngërthen në kuadër të tij sistemin **e kontrollit incidental.**

Shënojmë se ndikimi i sipërcekur francez në ngjizjen e sistemit të koncentruar (centralizuar) të gjyqësisë kushtetuese nuk ka ndodhur pas dekolonizimit të këtyre vendeve dhe fitimit të pavarësisë së tyre, por pas mbarimit të **Luftës së Ftohtë**. Para se të flasim shkurt për vendet frankofone të **Afrikës**, fillimisht sqarojmë fizionominë e gjyqësisë kushtetuese në **Afrikën e Jugut**: ky vend jo vetëm se është përjashtim nga ndikimi francez, por është përjashtim edhe nga ai britanik, sepse ka përqafuar një sistem të koncentruar (centralizuar) të gjyqësisë kushtetuese. Ky vend ka një gjykatë të ndarë kushtetuese, me juridiksion të qartë kushtetues dhe që nuk bën pjesë në kuadër të sistemit gjyqësor nacional me kompetencë të përgjithshme. Një fakti si ky paraqet situatë atipike për vendet e sistemit të së **drejtës së përgjithshme** (**common law**), ku hyn **Afrika e Jugut**.

Diskutimi i Afrikës së Jugut, para vendeve të tjera frankofone të Afrikës bëhet për tri arsye: e para, sepse **Afrika e Jugut** përbën një rast tipik të gjyqësisë së koncentruar (centralizuar) kushtetuese në një vend që i takon sistemit të së **drejtës së përgjithshme**; e dyta, **Afrika e Jugut** diskutohet edhe për shkak të praktikës gjyqësore jashtëzakonisht universale që mund të transplantohet në të gjitha shoqëritë në tranzicion që kanë kaluar nëpër situata të dhunës brutale shtetërore; dhe, së fundi, vendet e **Magrebi**t, si vende myslimane, i kemi diskutuar në kapitullin paraprak ashtu që do t'i bënim padrejtësi të madhe kontinentit të **Afrikës** sikur të mos diskutonim **Afrikën e Jugut** dhe modelet e gjyqësisë kushtetuese të vendeve frankofone që janë nën Sahara dhe në anën perëndimore të Afrikës. E kemi fjalën për vendet jo-anglofone të **Afrikës** sepse vendet anglofone në pjesën dërrmuese kanë ruajtur sistemin e gjyqësisë unike hierarkike që në krye të saj ka një gjykatë supreme (apo gjykatë tjetër të lartë me kompetencë të përgjithshme) dhe supremacinë e parlamentit. Aty ku ka një kontroll kushtetues në vendet anglofone, ai paraqitet si i llojit difuz (apo të decentralizuar), i dobët dhe pa ndonjë ndikim në çështjet e organizimit dhe frenimit (kontrollit) të pushtetit shtetëror, si dhe pa ndikim esencial në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive njerëzore sipas standardeve perëndimore të demokracive liberale kushtetuese. Këto funksione në këto vende, kontrolli dhe balancimi i pushteteve dhe mbrojta e lirive dhe të drejtave të individit, kryhen përmes mekanizmave dhe organeve të tjera shtetërore.

Në koloritin e madh të kontinentit më të madh në botë, **Azisë**, nga **Lindja e Largët** është përzgjedhur **Kina**, jo **Koreja e Veriut**. Kjo për arsye se ka rëndësi që lexuesi të shohë se si një vend komunist bazohet në një logjikë të caktuar të konstitucionalizmit për të siguruar një supremaci (epërsi) tjetër, supremacinë e ideologjisë komuniste, jo supremacinë (epërsinë) e kushtetutës kineze. Versioni i konstitucionalizmi komunist, në **Korenë e Veriut** shprehet në fytyrën e tij më ataviste: sundimi komunist në këtë vend nuk lejon asnjë mendim apo praktikë që asocon në konstitucionalizëm, përkatësisht që asocon në kontroll të pushtetit qoftë edhe në rastet kur ai kontroll do të ishte i bazuar në vetë ideologjinë komuniste. Kjo e dallon këtë vend nga Kina dhe e bën të panevojshëm studimin e tij në kontekstin e gjyqësisë kushtetuese dhe konstitucionalizmit komunist. E thënë me fjalë të tjera, për këto arsye fare nuk diskutohet kjo gjendje njerëzore që sot ekziston në **Korenë e Veriut,** që është kalimtare në kuptimin historik dhe që nuk çon asnjë peshë në mendimin dhe praktikën konstitucionaliste bashkëkohore. Rasti i **Koresë së Veriut** do të mbahet mend në diskursin akademik dhe tjetër lidhur me konstitucionalizmin bashkëkohor po aq sa rasti i **Kamboxhës** së diktatorit famëkeq **Pol Pot** (1925-1998), i cili fare dhe askund nuk zihet në gojë pikërisht për shkak se bëhet fjalë për triumf të modelit politik të udhëhequr nga, siç e ka cilësuar **Hanah Arendt** (1906-1975), "banaliteti i djallit", përkatësisht si një sundim i modelit politik të bazuar në mediokritet të skajshëm. Regjimet totalitare të tipit të **Pol Poti**-t apo të **Kores së Veriut** nuk dallojnë nga regjimi në **Gjermanisë Naziste** (1933-1945), ku njeriu si burokrat kthehet në zyrtar vrasës, njëjtë si mekanizimi që lëvizë rrotën, pra në një administratë të njerëzve të dehumanizuar dhe të pashpirt.[1] Diskutimi ynë për gjyqësinë kushtetuese nuk ka fare të bëjë me këtë lloj të regjimit politik dehumanizues: ajo çfarë ne mëtojmë të studiojmë ka të bëjë me përpjekjet njerëzore për kufizim të pushtetit dhe sigurim të një roli dinjitoz të individit në raport me pushtetin.

Krahas **Kinës** diskutojmë edhe **Tajvanin**, entitetin e plotë autonom, por që nuk është tërësisht sovran. Nuk e bëjmë këtë për t'i ofruar lexuesit historinë e **Tajvanit**, por për të shpalosur një sistem politik dhe kushtetues të ndryshëm nga ai kinez, i cili në pikëpamje të konstitucionalizmit dhe gjyqësisë kushtetuese nuk dallon aspak nga vendet tjera perëndimore. Në fakt, **Taivani** paraqet mishërim reflektues të përvojës perëndimore në fushën e kontrollit dhe balansimit të pushtetit përmes ndërtimit të mekanizmave përkatës kushtetues, përvojë e nuk dallon nga bota të cilën e imiton. E thënë me fjalë të tjera, **Tajvani** paraqet shembull shkollor të suksesit të botës jo-perëndimore në përqafimin e praktikave të njëjta me ato perëndimore në sferën e sundim të ligjit, respektimit të të drejtave të njeriut, si dhe ushtrim të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe formave të tjera të ushtrimit të pushtetit shtetëror. Përveç kësaj, **Tajvan**i përbën një rast unik edhe për faktin e njohur se në aspektin formal ai është pjesë e **Kinës**, sipas formulës së pranuar "një shtet, dy sisteme". Sistemi kushtetues kinez nuk ka asnjë ndikim në **Taivan**, sot për sot. Aty zbatohet një kushtetutë dhe një përvojë kushtetuese krejtësisht e ndryshme nga kushtetuta dhe përvoja kineze. Së bashku me këto dy vende të lindjes së largët trajtojmë edhe rastin e **Japonisë**, si një rast shumë interesant dhe unik në shumë aspekte.

Nga **Lindja e Mesme** kemi përzgjedhur **Izraelin**, për t'i dhënë lexuesit një pasqyrë se si mund të mbijetojë, në një ambient krejtësisht të ndryshëm nga konstitucionalizmi liberal perëndimor të cilin e kopjon, një konstitucionalizëm që esencialisht i përket proveniencës fetare tërësisht hebreje. Ambienti përreth **Izraelit** është i ndryshëm për shkak se konstitucionalizmi atje, përveç që është arab, ai ka stof të theksuar islamik me bazë kuranore. Kjo nënkupton që, me përjashtim të **Egjiptit**, për të cilin folëm në kapitullin paraprak, Kurani dhe **Sheriati Islamik** përbëjnë bazën themelore të legjitimitetit të pushtetit dhe të krejt korpusit të së drejtës pozitive.

Vendi më i afërt mysliman që i afrohet **Izraelit** në aspektin konceptual është **Turqia**. Kjo ka qenë arsye pse në fillim diskutojmë **Turqinë**, e cila matet jo vetëm më **Izraelin**, por, duke qenë një vend

[1] Cf. me shumë dhe në detaje për këtë në Hannah Arendt, *Eichmann in Jerusalem: A Report on the Banality of Evil* (Penguin Classics: London, 2006).

islamik, rrezaton dhe ka rrezatuar ngjashmëri me vendet tjera të **Juglindjes së Azisë**. Në këtë kontekst duhet parë edhe përzgjedhjen tonë të dy vendeve nga ky rajon, **Indonezisë** dhe **Malejzisë**, të cilat paraqesin një model për vendet tjera ashtu që diskutimi i mëtejmë i vendeve të atij rajoni do të ishte vetëm në interes të atyre që studiojnë diferencat e thella të sistemeve të gjyqësisë kushtetuese në atë pjesë të botës.

Mbase lexuesi do çuditet pse diskutohet këtu për vendet e **Azisë Qendrore** dhe **Mongolinë,** jo për **Indinë**, e cila bën pjesë në demokracitë më të mëdha të botës. E njëjta vlen edhe për **Pakistanin** dhe **Afganistanin**, të cilët nuk i diskutojmë në këtë libër, po ashtu për arsyet e cekura si më sipër: **India** paraqet një shembull të një demokracie model, të stabilizuar me një gjyqësi të pavarur, ku **Gjykata Supreme e Indisë**, njëjtë si ajo në **SHBA** dhe vendet që modelohen sipas sistemit amerikan, ka një ndikim të madh dhe me shumë sukses ka arritur të ruajë demokracinë kushtetuese indiane në kohërat më të vështira të shtetformimit.[2] Me **Pakistanin**, gjendja po ashtu paraqitet e njëjtë sepse ky vend nuk ka ndonjë specifikë që duhet të na preokupojë. Si një vend islamik, nuk dallon dukshëm nga Egjipti: **Gjykata Supreme e Pakistanit** (GJSPa) ka arritur deri më sot të ruaj parametrat themelor të sistemit kushtetues dhe politik të këtij vendi, me një vendimmarrje të guximshme në kohët e diktaturës së gjeneralëve pakistanezë përgjatë dekadave të **Luftë së Ftoftë** dhe pas mbarimit të saj. Sa i përket rolit dhe pozitës së Islamit në shoqëri, gjendja në Paksitan po ashtu nuk ndryshon shumë nga Egjipti: edhe në këtë vend **Kurani** paraqitet si një burim i interpretimit të legjislacionit pozitiv, ani se në një mënyrë shumë më të ndryshme se në rastin e Egjiptit. Gjykuar sipas dispozitave të **Kushtetutës së Pakistanit** të vitit 1973, në fuqi aktualisht, si dhe përvojës së bazuar në këtë kushtetutë,[3] historia kushtetuese e **Pakistanit** i ngjason më shumë **Iranit**, mirëpo me një sistem kushtetues që bazohet në një islam tjetër, në **Islamin Suni**.[4] U mor vesh, në **Pakistan** nuk ka pasur një revolucion islamik të llojit teokratik, ani se ndikimi i Islamit ka qenë tepër i madh dhe i tillë ngelet akoma: në këtë kuptim, mund të thuhet se në shumëçka ngjason edhe me **Arabinë Saudite**, marrë parasysh llojin e njëjtë të Islamit në dy vendet.

---

2 Cf më shumë në lidhje me këtë në Domentico Amirante, "Giustizia costituzionale e affermazione dellla democrazia nell'Unione indiana". Në Luca Mezzetti (ed.), *Sistemi e modelli di giustizia costituzionale* (CEDAM: Padova, 2009) fq. 713-756 në fq. 7567-784.

3 *The Constitution of the Islamic Republic of Pakistan of 1973 with amednments through 2017*. Në internet: http://www.pakistani.org/pakistan/constitution/ (shikuar në korrik 2017).

4 Cf. Nenin 2 ["Islami si Religjion Shtetëror"] të Kushtetutës: "Islami do të jetë religjion shtetëror i Pakistanit", në lidhje me Pjesën IX ["Dispozitat Islamike'} të Kushtetutës. Kjo pjesë lidhur me dispozitat islamike, më tutje operacionalizin këtë nen në nenet e saj 22-231. Në nenin 227.1 '["Dispozitat që kanë të bëjnë me Kuranin dhe Sunet"] i kësaj pjesë e bënë të qartë se çdo ligj që bie ndesh me Kuranin e Shenjët dhe me Thëniet e dhe Veprat e Profetit, janë Urdhra të Shenjta të Islamit.
Këto dispozita si më sipër kanë precedente gjyqësore të cilat dëshmojnë për prioritetin e Urdhrave të Islamit kundrejt dispozitave kushtetuese që janë në kundërshtim me të. Krahaso, ta zëmë, praktikën gjyqësore lidhur me nenet si më sipër përgjatë dekadave, në komentarin e Zain Sheikh të Kushtetutës së Pakistanit: *CONSTITUTION OF THE ISLAMIC REPUBLIC OF PAKISTAN, 1973. As Amended by The Constitution Twenty Third Amendment Act, 2017* (**Full Text and Case Law**), developed by Zain Sheikh. Në internet: https://pakistanconstitutionlaw.com/ (shikuar në korrik 2017)
Përveç si më sipër, në **Kushtetutën e Paksitanit** ekziston një kapitull i veçantë për gjykatat e bazuara në **Sheriatin Islamik**, kapitullin 3A të Pjesës së VII ["Gjyqësori"], si mekanzima implementues të Urdhrave të Islamit. Në këtë kapitull prej neneve 203 A – 203J normohet organizimi, puna, juridiksioni, vendimmarrja dhe natyra e vendimeve të gjykatës me karakter thellësisht islamik të llojit **Suni**, **Gjykatës Federalke të Sheriatit**. Në nenin e parë 203A të Kushtetutës thuhet se "dispoztat e këtij kapitulli qëndrojnë mbi dispozitat tjera të Kushtetutës". Se kjo është kështu shihet edhe nga juridksioni i kësaj gjykate: në nenin 203D.1 theksohet se Gjykata [...] mund të vihet në lëvzje me vetëiniciativë, me kërkesë të palëve, të qeverisë qendre apo provinciale, me qëllim të shqyrtimit dhe vendsojes nëse një dispozitë ligjore apo një ligj është në kudërshstim me urdhrat e Ilsamit, ashtu sic janë përcaktuar me **Kuranin e Shenjët** dhe **Thëniet dhe Veprat e Profetit të Shenjët**, këtu e tutje të cituar si **Urdhrat e Islamit** [...]." Dispozitat në vijim të këtij kapitulli e bëjnë shumë të qartë se apelimi kundër këtyre vendimeve ka pak gjasë të ketë sukses në **GJSPa**, e cila kur vendos për lëndët e **Gjykatës Federale të Sheriatit** (GJFSHP) përbëhet nga gjyqtarë islamikë. Jo vetëm kaq! Dhënia e lejes (certifikimi i rasteve të **GJFSHP** për vendosje në **GSPa**) është mjaft i rrallë. Edhe atëherë kur jepet leja, fjala është për konfirmimin (vërtetim) të verdiktit islamik të shqiptuar nga **GJFSHP**.
Për komentet teorike lidhur me ndikimin dominant të Islamit Suni në gjyqësorin pakistanez dhe në përgjithësi në jetën juridiko-kushtetuese dhe politike të Paksitanit, Cf. në Martin Lau, *Role of Islam in the Legal System of Pakistan* (Martinus Nijhoff Leiden, 2005); Corri Zoli, Emily Schneider, "Hoë Islamic Is Pakistan's Constitution". *Foreign Policy* 15 May 2014; http://foreignpolicy.com/2014/05/15/how-islamic-is-pakistans-constitution/ (shikuar në korrik 2017); Jayshree Bajoria, "Pakistan's Constitution". *Washington Post Tuesday* March 11, 2008 / 12:47 PM/. Në internet: http://www. washingtonpost. com/wp-dyn/content/article/2008/03/ 11/AR2008031101365.html (shikuar në korrik 2017).

T'i kthehemi tani çështjes së disa prej vendeve të **Azisë Juglindore**, të cilat i diskutojmë në këtë kapitull, për shkak të specifikave të tyre të përbashkëta në lëmin e gjyqësisë kushtetuese. Specifikat e vendeve, të përzgjedhura për diskutim këtu (**Indonezia**, **Koreja e Jugut** dhe **Malejzia**), konsistojnë në atë se gjyqësia e tyre kushtetuese ka pasur një transformim rrënjësor, në veçanti pas mbarimit të **Luftës së Ftohtë**: nga kjo kohë, gjykatat kushtetuese të këtyre vendeve, nga instrumente të garancionit të ngurtësisë së kushtetutës janë kthyer në mekanizma të vënies në jetë të strukturave demokratike-përfaqësuese, të kontrollit dhe të garantimit të legalitetit dhe legjitimitetit kushtetues. Në kuadër të shikimit të gjyqësisë kushtetues të këtyre vendeve dhe të mekanizmave për vënien e saj në jetë duhen parë edhe kompetencat mjaft të ndryshme dhe specifike të secilit prej tyre.[5]

Para se të kalojmë në trajtimin e gjyqësive kushtetuese të vendeve të **Azisë Juglindore**, të cilat i diskutojmë në seksionet pesë, gjashtë dhe shtatë, diskutimi ynë në seksionin e parë dhe të dytë fillon më **Turqinë** dhe **Izraelin**.

Më pastaj, në seksionin e tretë nisim shtjellimet tona për vendet e **Azisë Qendrore** (plus **Azerbajxhanin**). Këto vende përfaqësojnë një kolorit në aspektin e mekanizmave dhe dizajnit institucional kushtetues, të përzgjedhur me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së kushtetutës pas rënies së komunizmit. Krahas këtij koloriti institucional, në kushtetutat e këtyre vendeve një vend të spikatur zënë edhe dispozitat mbi të drejtat dhe liritë njerëzore. Ne, megjithatë, nuk i diskutojmë me këtë rast në mënyrë specifike dispozitat e tilla. Ajo çfarë diskutojmë këtu ka të bëjë me **ankesën kushtetuese** dhe natyrën e saj, e cila ekziston në kushtetutat e këtyre vendeve dhe ka për qëllim adresimin e shkeljeve të të drejtave dhe lirive të garantuara me kushtetutë. Vënia në spikamë dhe analizimi i dispozitave që kanë të bëjnë me ankesën kushtetuese, ka për qëllim që lexuesit të ofrohet një pasqyrë e qartë e zotimit të këtyre vendeve për të vënë sa më shumë barriera dhe kufizime ndaj pushtetit politik duke fuqizuar rolin dhe pozitën e individit në shoqëritë e tyre, të cilat kanë vuajtur për dekada të tëra nën sundimin komunist sovjetik.

Pikërisht për shkak se ka qenë një vend sovran dhe ka përqafuar zgjidhje tipike **evropiane/kelseniane**, të dallueshme nga vendet e **Azisë Qendrore**, Mongolinë e kemi ndarë veçmas në seksionin e shtatë në vijim. Kjo qasje i mundëson lexuesit për t'i parë dallimet dhe ngjashmëritë në mes këtyre vendeve dhe **Mongolisë**, si në aspektin e zhvillimit historik ashtu edhe sa i përket dizajnit institucional kushtetues brenda të cilit zhvillohet gjyqësia kushtetuese.

Seksioni në vijim, i nënti, trajton **Afrikën e Jugut** dhe disa vende të tjera, kryesisht **frankofone**, të kontinentit afrikan. Arsyet për këtë qasje u dhanë më sipër dhe serish jepen me rastin e trajtimeve tona në këtë seksion.

Seksionet dhjetë dhe njëmbëdhjetë i dedikohen komenteve dhe pyetjeve, si dhe literaturës shtesë. Këto segmente mund ta ndihmojnë lexuesin për të zhvilluar vetitë analitike në lëmin e gjyqësisë kushtetuese si dhe për të thelluar më shumë dijen në këtë fushë, jo vetëm lidhur me vendet që janë trajtuar në këtë kapitull por edhe më gjerë.

8.1. Turqia

Në historinë kushtetuese të Turqisë moderne kanë ekzistuar katër kushtetuta: **Kushtetuta e Turqisë** e vitit 1921,[6] **Kushtetuta e Republikës së Turqisë** e vitit 1924,[7] **Kushtetuta e Republikës së Turqisë** e vitit 1961[8]

---

5 Luca Fanoto, "La giustizia costituzionale negli ordinamenti asiatici (Corea del sud, Mongolia, Taiwan, Indonesia)". Në Luca Mezzetti (ed.), *Sistemi e modelli di giustizia costituzionale*, fq. 713-756 në fq. 743.

6 *The 1921 Turkish Constitution* (Selections). Në internet: http://genckaya.bilkent.edu.tr/1921C.html (shikuar në gusht 2017).

7 Edward Mead Early, "The New Constitution of Turkey". *Political Science Review* Volume 40 Issue 1 (March 1925) fq. 73-100 në fq. 89-100. Në këtë shkrim, autori përveç që jep në fund tekstin integral të kësaj kushtetute, shtjellon deri në detaje lindjen e saj, kontekstin historik të prishjes së kalifatit dhe sulltanatit, fitores së turqve në luftën për pavarësi si dhe njohjen e Republikës së Turqisë në planin ndërkombëtar si një shtet i ri i pavarur.

8 Journal Article, "The Constitution of the Republic of Turkey (1961)". *Islamic Studies* Vol. 2 No. 4 (December 1963) fq. 467-519.

dhe **Kushtetuta e Republikës së Turqisë** e vitit 1982. Kjo e fundit aktualisht është në fuqi në këtë vend.[9] Në kuptimin e temës që diskutojmë, pra në kuptim të analizës së kontrollit kushtetues, historisë, modaliteteve të zbatimit si dhe në kuptim të arsyeve për ekzistimin e tij një rëndësi të veçantë e ka edhe **Kushtetuta e Perandorisë Otomane** e vitit 1876.[10] Nga të gjitha këto kushtetuta, vetëm Kushtetuta e vitit 1921 nuk ka pasur asnjë dispozitë lidhur me cilëndo formë të manifestimit të gjyqësisë kushtetuese. Kjo rrethanë ka rëndësi të veçohet me këtë rast.

Shenjat e para të gjyqësisë kushtetuese turke i gjejmë në dispozitat e Kushtetutës së vitit 1876, ani se në literaturë përmendet ekzistimi më herët i një lloj marrëveshjeje për aleancë, e lidhur në vitin 1808 në mes të Sulltanit të Perandorisë Otomane, **Sulltan Mahmutit të Dytë**, dhe aristokracisë vendore të kohës.[11] Kjo marrëveshje dhe reformat që kanë pasuar, kanë rëndësi të madhe për zhvillimin kushtetues të këtij vendi: marrëveshja ka synuar, por pa ndonjë sukses, ndërtimin e një qeverisjeje të kufizuar dhe kushtetuese, sipas standardeve evropiane të kohës.

Në këtë kontekst, ka rëndësi që t'i shohim disa nga dispozitat e Kushtetutës së vitit 1876 që flasin për supremacinë (epërsinë) e kushtetutës dhe disa kategori të tjera që në mënyrë të qartë flasin për kontrollin politik të kushtetutshmërisë që parashikohej në atë kushtetutë. Kështu, në nenin 115 ["Dispozitat e Ndryshme"] të Kushtetutës stipulohej në mënyrë të qartë se asnjë dispozitë e saj nuk mund të pezullohej e as të anashkalohej mbi bazën e asnjë preteksti. Me këtë stipulim, kjo kushtetutë në mënyrë të qartë ka bërë zgjidhjen në favor të supremacisë (epërsisë) së kushtetutës kundrejt çdo akti tjetër juridik. Me këtë dispozitë përcaktohej në parim se Kushtetuat paraqiste rregullatorin e jetës perandorake dhe se normat e saj nuk mund të mënjanoheshin (pezulloheshin ose anashkaloheshin), pa marrë parasysh pretekstin. Ky përcaktim, në mënyrë implicite, ka nënkuptuar se edhe ligjet dhe aktet e veprimet tjera duhet t'i nënshtroheshin dispozitave të Kushtetutës. E tërë kjo, megjithatë, duhet parë në kontekstin e të prerogativave perandorake të Sulltanit, të cilat ishin afërsisht të njëjta me prerogartivat perandorake të perandorëve të tjerë evropianë të kohës. Këto prerogativa garantoheshin dhe përcaktoheshin me Kushtetutë. Në këtë kuptim, si të tilla, ato prerogativa nuk ishin pengesë për të siguruar dhe promovuar teorinë dhe praktikën e supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës meqë këto dy koncepte nuk përjashtojnë njëri tjetrin.

Për të siguruar supremacinë (epërsinë) e Kushtetutës, parashikohej **kontrolli politik i kushteutshmërisë**. Ai normohej me dispozitat e nenit 64 ["Senati"] të Kushtetutës, të cilat shprehimisht përcaktonin kontrollin politik të kushtetutshmërisë që zhvillohej në dy dhomat e Parlamentit të Perandorisë, i njohur si **Asambleja e Përgjithshme**. E para dhomë apo **Senati**, sipas dispozitës së nenit 64 si më sipër, kishte për detyrë të kryente shqyrtimin e ligjeve dhe të buxhetit perandorak të cilat, pas këtij shqyrtimi, ia kalonte për miratim dhomës së dytë, **Dhomës së Deputetëve**. Nëse **Senati** gjente se një ligj binte ndesh me të drejtat sovrane të Sulltanit, lirinë, Kushtetutën, integritetin territorial të Perandorisë, interesat nacionale të vendit që kanë të bëjnë me mbrojtjen, moralin etj., atëherë ai, pra Senati, mund ta refuzonte atë duke dhënë arsyet për një gjë të tillë. Kjo dispozitë, përveç kësaj,

---

9 *Constitution of the Republic of Turkey* (1982). Në internet: https://global.tbmm.gov.tr/docs/constitution_en.pdf (shikuar në gusht 2017). Kjo kushtetutë deri më sot është amendamentuar shtatëmbëdhjetë herë: në vitin 1987, 2007, 2010 dhe 2017. Amendamentimet përfshijnë gati rreth 80 për qind të neneve të saj.

10 *The Ottoman Constitution* (23 December 1876). Në internet: http://www.anayasa.gen.tr/1876constitution.htm (shikuar në gusht 2017).

11 Kjo marrëveshje, e cilësuar edhe si një **Magna Charta e Perandorisë Otomane**, nuk parashikonte ndonjë zgjidhje sa i përket kontrollit kushtetues në kuptimin e sotëm të fjalës. Kjo më shumë ishte një përpjekje e autoriteteve otomane të kohës për t'iu përshtatur presionit të jashtëm për modernizim dhe themelim të një shteti që do të funksiononte sipas standardeve evropiane të kohës. Ky presion më vonë u reflektua në ato që njihen si **Reformat e Tanzimatit** (1839). Me këto reforma iu njohën shtetasve të Perandorisë Otomane disa të drejta dhe liri njerëzore, heqja e disa taksave të rënda, u proklamua barazia para ligjit pa asnjë dallim etj. Mbi të gjitha, me Tanzimat-in themelohet **Këshilli i Lartë i Drejtësisë**, si një lloj organi ligjvënës, i cili bënte hartimin e ligjeve dhe shumë akteve tjera perandorake. Mbi të gjitha, ky Këshill dhe përpjekjet e otomanëve për modernizim çuan në nxjerrjen e Kushtetutës së vitit 1876, e cila modelohej sipas kushtetutave të kohës të perandorive tjera evropiane. Cf. Ergun Ozbudun, *The Constitutional System of Turkey: 1876 to the Present* (PALGRAVE MACMILLAN: New York, 2011) fq. 2.

Senatit i jepte të drejtën që ta kthente ligjin prapa në Dhomën e Deputetëve me mendimet e veta, duke kërkuar nga Dhoma që t'i bëjë ndryshimet e duhura sipas sugjerimeve dhe vërejtjeve të dhëna nga Senati. Kjo, përtej çdo dyshimi, përbën kontroll politik të kushtetutshmërisë.[12] Për kohën e vet pak a shumë i ngjanë përvojave të vendeve të tjera evropiane të kohës.

Përkundër këtyre dispozitave tërheqëse, të modeluara sipas standardeve të kohës, kjo Kushtetutë u suspendua në vitin 1878 nga **Sulltan Abdyl Hamiti i Dytë**, i cili, në fakt, e kishte përdorur atë për të penguar presionet perëndimore për reforma dhe progres në shtetin që ai e drejtonte më shumë se sa për të zhvilluar ndonjë konstitucionalizëm të mirëfilltë. Në literaturë është vërejtur se sikur të ishte respektuar, Kushtetuta e viti 1876 do të kushte krijuar kushte solide për zhvillimin e institucioneve parlamentare dhe krijimin e një qeverisjeje kushtetuese në **Perandorinë Otomane**. Kjo nuk ndodhi si pasojë e obstruksioneve të Sulltanit, i cili në vitin 1909, u dëbua nga froni nga lëvizja revolucionare e **Turqve të Rinj** (të njohur si **Xhonturqit**), të cilët bënë restaurimin e Kushtetutës së vitit 1876 dhe të sovranitetit të parlamentit që sanksionohej me atë kushtetutë. Si pasojë e gjendjes së krizës së thellë ekonomike e financiare, rritjes së nacionalizmit në Perandori, luftërave ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore, as Turqit e Rinj nuk arritën të bëjnë diçka më shumë se **Sulltan Abdyl Hamidi i Dytë**: ata nuk lanë prapa vetës asnjë shenjë serioze e jetës parlamentare dhe konstitucionalizmit serioz.[13]

Kushtetuta e vitit 1921 nuk ka përmbajtur asnjë dispozitë lidhur me gjyqësinë kushtetuese apo kategoritë tjera të përafërta me te. Organi kryesor i pushtetit ishte **Asambleja e Madhe e Turqisë**, e cila në të njëjtën kohë ushtronte funksionin ligjvënës dhe kushtetutëdhënës. Kushtetuta ka qenë e shkurtër dhe ka pasur gjithsej 23 dhe ka shërbyer si një dokument kalimtar deri kur është nxjerrë Kushtetuta e vitit 1924 dhe u bë shpallja e **Republikës së Turqisë** një vit më parë.

Kushtetuta e vitit 1924 ka parashikuar supremacinë (epërsinë) e Kushtetutës në nenin 103 ["Amendamentimet e Kushtetutës"]. Në këtë nen përcaktohej se asnjë dispozitë e Kushtetutës nuk mund të ndryshohej në mënyrë arbitrare, pa marrë parasysh pretekstin, e as nuk mund të bëhej pezullimi i zbatimit të dispozitave të saj. Për më tepër, në mënyrë të qartë në paragrafin e fundit të këtij neni përcaktohej se asnjë ligj nuk mund të binte ndesh me Kushtetutën. Kjo kushtetutë, megjithatë, nuk parashikonte asnjë mekanizëm për kontroll kushtetues të normave juridike e as për vënien në jetë të dispozitave të saj. Kjo do të bëhet shumë më vonë, me Kushtetutën e vitit 1961. Në literaturë, megjithatë, është vërejtur se në kohën ndërmjet dy kushtetutave ka ekzistuar një lloj **kontrolli i decentralizuar** (**difuz)** i kushtetutshmërisë, kontroll që ka qenë i natyrës funksionale sepse askund nuk ka qenë i parashikuar në dispozitat e Kushtetutës së vitit 1924. Ka edhe një arsye tjetër që tregon se fjala ka qenë për një kontroll **të decentralizuar (difuz)** me natyrë funksionale: ushtrimi i tij është bazuar jo në parime hermeneutike me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës, por ekskluzivisht me qëllim të sigurimit dhe ruajtjes së parimeve të njohura si **kemalizëm** (sipas emrit të themeluesit të Turqisë moderne, **Mustafa Kemal**, i njohur si **Ataturk)**. Në këto **parime kemaliste** bëjnë pjesë: forma republikane e shtetit dhe laiciteti. Në këto raste, gjyqtarët nuk bënin moszbatimin e ligjit, por reinterpretimin e tij sipas parimeve të **kemalizmit**, të cilat parime ishin jashtëzakonisht të gjëra dhe me shumë kuptime gjë që linte hapësirë për interpretime arbitrare sepse interpretimi kemalist nuk bazohet në parimet standarde hermeneutike të profesionit legal. Kjo gjendje ka zgjatur gjatë deri me nxjerrjen e Kushtetutës së vitit 1961, në një kontest shumë specifik dhe interesant social dhe politik. Paraqitjes së këtij konteksti i kthehemi në vijim. Siç do të shihet, edhe pas vitit 1961, parimet e kemalizmit luajtën një rol të madh në qeverisjen turke dhe, mbi të gjitha, në krijimin e gjyqësisë kushtetues turke me juridiksion të ndarë në vitin 1961.

---

[12] Ergun Özbudun, "Ottoman Constitution of 1876" *Max Planck Encyclopedia of Comparative Constitutional Law* (Article last updated: May 2016), paragrafët: 1-29, në paragrafin 12 (ku autori citon nenin 64 të Kushtetutës si një shembull tipik mjaft i hershëm i kontrollit politik të kushtetutshmërisë).

[13] Shih për analizën e ngjarjeve të kohës rreth suspendimit të Kushtetutës në vitin 1878, fitoren dhe dështimin e lëvizjes së **Turqve të Rinj** në Edward Mead Early, "The New Constitution of Turkey", fq. 76-80.

Sistemi shumëpartiak, i futur ndërkohë në Turqi pas Luftës së Dytë Botërore, mundësoi mbajtjen e zgjedhjeve të para shumëpartiake në vitin 1950, ani se formalisht në fuqi ishte Kushtetuta e vitit 1924. Fituese e zgjedhjeve doli **DP** (DP: "Demokratik Partisi"), atëherë në opozitë. **Partia e Ataturkut**, e njohur si **CHP** (CHP: "Cumhuryet Halk Partisi") apo **Partia Popullore Republikane**, derisa atëherë kishte qenë në pushtet. Në aspektin formal, Kushtetuta e vitit 1924 nuk parashikonte një sistem shumëpartiak dhe as zgjedhje te lira në kuptimin e sotëm të fjalës. Kjo kushtetutë nuk kishte asnjë dispozitë për ndarje dhe balansim të pushteteve si dhe asnjë garancion legal për të liritë dhe të drejtat e njeriut. Këto të meta, si dhe mungesa e kontrollit kushtetues të ligjeve turke, të cilat shiheshin si shprehje e vullnetit të sovranit dhe sundimit të shumicës, çuan deri te dështimi i Kushtetutës së vitit 1924 dhe abuzimi i hapur i vullnetit të shumicës. Qeveria e DP-së, ish opozitës turke, e shihte sovranitetin parlamentit si diçka absolute që i jepte mandate dhe pushtet të pakontrolluar. Kjo parti nuk konsiderohej si parti e Ataturkut. Në vitin 1960 ndërhyri ushtria turke për të rrëzuar qeverinë e **DP**-së.[14]

Fitorja e opozitës dhe e logjikës rusoane të parimit të sundimit të shumicës, të cilin vullnet e kontrollonte ish opozita turke, tani pozitë me në krye **DP**, ndezi alarmin në qarqet elitike të **CHP-së,** të ushtrisë dhe shtresës intelektuale turke për nevojën e krijimit të një mekanizmi që do të bënte kontrollin kushtetues të vullnetit të shumicës dhe të sovranit turk. Një mekanizëm i tillë nuk arriti të krijohej sepse ndodhi grusht shteti ushtarak (1960), i cili u arsyetua në publik si hap që kishte për synim frenimin e demokracisë së shfrenuar populliste të partisë opozitare dhe abuzimin me pushtetin e saj ekzekutiv. Ata që hartuan Kushtetutën e vitit 1961, nën rrethanat e një regjimi ushtarak, në kontekstin e situatës së krijuar, u pajtuan për themelimin e një gjykate kushtetuese si një mekanizëm që do të frenonte dhe kontrollonte kushtetutshmërinë e vullnetit të sovranit të shprehur përmes ligjeve. Ky kontekst krejtësisht elitik i themelimit të **Gjykatës Kushtetuese të Turqisë** (**GJKTr**) në vitin 1961, ku rol parësor luajtën ushtria dhe burokracia turke, të ndihmuar hapur nga shtresa e mesme dhe intelektualët, u cilësua si sistem politik hegjemonik.

Në konsolidimin dhe ruajtjen e këtij sistemi hegjemonist, Gjykata Kushtetuese ka luajtur një rol të madh. Ky rol u mundësia nga juridiksioni mjaft i gjerë që iu njoh kësaj gjykate. Ky juridiksion reflektonte nevojat specifike të elitës turke që për veprimit në mbrojtje të vlerave të laicitetit dhe republikanizmit, përkatësisht të **parimeve themelore të kemalizmit**. Koncepti elitik në fizionominë dhe juridiksionin e Gjykatës u ruajt dhe u manifestua edhe më vonë pas vitit 1961, gjatë tërë kohës së Luftës së Ftohtë e deri vonë, deri në vitin 2002, kur në pushtet erdhi partia e **Rexhep Taip Erdogan**-it (**Recep Tayyip Erdoğan**), kryetarit aktual të **Turqisë**[15].Në të njëjtën kohë, Erdogan është edhe shef i partisë së themeluar nga ai në vitin 2001, **AKP-së** (**Adalet ve Kalkınma Partisi**), **Partisë për Zhvillim dhe Drejtësi.**[16]

Pas ardhjes në pushtet të AKP-së ka pasur shpresa se **GJKTr** do të mund të luante rolin e zbutësit të islamit politik dhe të ndikojë në moderimin e konfliktit në shoqërinë turke duke çuar përpara proceset e demokratizimit në mënyrë të kontrolluar. Kjo, megjithatë, u provua e gabuar sepse me amendamentet e fundit të vitit 2017, **GJKTr** në tërësi ka marrë pozitën e nënshtrimit ndaj pushtetit islamist të AKP-së dhe po humb në mënyrë graduale rolin e saj të moderatorit të proceseve politike kundrejt tiranisë së shumicës si

---

[14] Yasushi Hazama, "Hegemonic preservation or horizontal accountability: constitutional review in Turkey". *International Political Science Review* Vol. 33 No. 4 (2012) fq. 421-440, në fq. 425-427.

[15] Serdar Gülener and İrfan Haşlak, "Relations between Politics and Constitutional Review in Turkey with Special Reference to the Referrals of Republican People's Party: 2002-2010 Period" ***ALTERNATIVES:*** *TURKISH JOURNAL OF INTERNATIONAL RELATIONS* Vol. 10 Nos. 2-3 (Summer – Fall, 2011) fq. 1-19 në fq. 3-6.

[16] Në literaturën empirike në shkencat politike, në elitat politike turke ndahen në elita shtetërore dhe në elita jo-shtetërore. Elitat shtetërore janë ato që krijuan Gjykatën Kushtetuese në vitin 1961, kure si jo-shtetërore cilësohen elitat e sjella në pushtet pas vitit 2001. Ne, megjithatë, këto elita jo-shtetërore më shumë i shohim si lëvizje populliste të periferisë turke, të cilat, në emër të lirisë fetare dhe barazisë sociale, po ndyrshojnë çdo ditë e më shumë parimet themelore të kemalizmit, përkatësisht të sundimit të laicitetit dhe republikanizimit turk ku ideja për legalitet, një komb dhe një shtet, si dhe për unitetin nacional po humb nga vlera e vet origjinale. Cf. për dallimet në elita si më sipër, në Ibid. fq. 423-425 (ku autori flet për elitat e dy llojeve si variabla të pavarura, të cilat paraqiten si palë të autorizuara pranë **GJKTr**).

dhe rolin e kontrolluesit e ruajtësit të **parimeve të kemalizmit.**[17] Ata që besuan se ky proces do të shkojë në drejtim të demokratizimit të kontrolluar të shoqërisë turke, ku **GJKTr** do të arrinte të shërbente si një ruajtëse e sistemit kemalist, ashtu siç ishte paramenduar me rastin e themelimit të saj në vitin 1961, me kohë u provuan si të gabuar.[18]

Të shohim nga afër si ka ndodhur ky ndryshim i konceptit elitik të gjyqësisë kushtetuese turke, ndryshim që ka qenë pjesë e ndryshimit të përgjithshëm në zhvillimit socio-politik, ekonomik dhe kulturor të Turqisë që nga viti 2001 deri më sot.

GJKTr ka nisur punën për herë të parë pas shpalljes së një ligji organik më datën 22 prill 1962, i cili normonte organizimin, strukturën dhe punën e Gjykatës Kushtetuese.[19] Sipas nenit 145 pika nën "a" ["Gjykata Kushtetuese"] të Kushtetutës, **GJKTr** përbëhej nga 15 gjyqtarë të rregullt dhe pesë gjyqtarë zëvendësues (rezervë). Caktimi i gjyqtarëve të rregullt behej nga disa organe: katër nga Gjykata e Kasacionit, tre nga Këshilli i Shtetit, një nga Gjykata e Auditimit, tre nga Asambleja e Nacionale, dy nga Senati[20] dhe, së fundi, dy nga Presidenti i Republikës. Sikundër shihet, këtu ka pasur një përfshirje të organeve të larta të shtetit (parlamentit, gjyqësorit dhe presidencës turke) në caktimin e gjyqtarëve të **GJKTr**.

Kjo ka ndryshuar rrënjësisht me kushtetutën e vitit 1982, po ashtu e nxjerrë pas grusht shtetit ushtarak të vitit 1980. Sipas nenit origjinal 146 ["Gjykata Kushtetuese"] të Kushtetutës së vitit 1982, parlamenti turk në tërësi përjashtohej nga procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për gjyqtarë, duke e lënë këtë të drejtë ekskluzivisht në duart e presidentit. Kjo praktikë ka ndryshuar me amendamentet kushtetuese të vitit 2010, mirëpo Presidenti sërish ka një rol të madh duke ia lënë **Asamblesë së Madhe Nacionale** luajtjen e një roli të kufizuar në këtë mes. Sipas këtyre amendamenteve, të cilat kanë ndryshuar sërish në prill 2017[21], **GJKTr** përbëhet prej 17 anëtarëve. **Asambleja** i zgjedh dy anëtarë nga tre kandidatët e nominuar nga plenarja e **Gjykatës së Auditimit** dhe një nga tre kandidatë e nominuar nga presidentët

---

17 Cf. për këto shpresa iluzore, të ushqyera mbi bazën e rezultateve të një studimi empirik të autorëve lidhur me rolin dhe pozitën e **GJKTr** në sistemin politik dhe kushtetues turk si dhe rolin e saj në ruajtjen e rregullave të lojës politike, në Hootan Shambayati and Güliz Sütçü, "The Turkish Constitutional Court and the Justice and Development Party (2002–09)". *Middle Eastern Studies* Vol. 48 No. 1 (2012) fq. 107-123; Për autorët që me kohë kanë parë se aktivizimi i **GJKTr n**ë rastin e anulimit të amendamenteve kushtetuese lidhur me bartjen e shamisë në universitete (2008), si dhe tendencat e nisura që atëherë për të mos vënë në jetë disa nga vendimet e saj që bien ndesh me vullnetin e shumicës, duke krijuar kështu tensione në demokracinë kushtetuese turke, shih më shumë në Ali Acar, "TENSION IN THE TURKISH CONSTITUTIONAL DEMOCRACY: LEGAL THEORY, CONSTITUTIONAL REVIEW AND DEMOCRACY". *Ankara Law Review* Vol. 6 No. 2 (Winter 2009) fq. 141 -173.

18 Për autorët që kanë besuar se **GJKTr** do të arrijë të jetë një ruajtëse e sistemit Kemalist kushtetues, cf. më shumë në Esin Örücü, "The Constitutional Court of Turkey: The *Anayasa Mahkemesi* as the Protector of the System". *Journal of Comparative Law* Volume 3, Number 2, 2008 fq. 254-268 në fq. 256-257 (por edhe në faqet në vijim deri në fund, ku autori shtjellon gjerësisht rolin e saj si ruajtëse e sistemit ashtu siç është kuptuar ky koncept me rastin e themelimit të saj me Kushtetutën e 1961).

19 *The Law on the Establishment and Judgement Procedures of the Constitutional Court* (No. 44, 22 April 1962). Në internet: http://www.constitutionalcourt.gov.tr/inlinepages/constitutionalcourt/shorthistory.html (shikuar në gusht 2017).

20 Sipas paragrafit të parë të nenit 63 të Kushtetutës së vitit 1961, **Asambleja e Madhe Nacionale** përbëhej nga Asambleja Nacionale dhe Senati.

21 Në referendumin e 16 prill 2017, janë miratuar amendamentet kushtetuese, të cilat në thelb rrënjësisht kanë ndryshuar sistemin turk të qeverisjes, duke e kthyer në një sistem presidencial me premisë diktatoriale dhe duke mënjanuar në mënyrë efektive konceptin kemalist të Turqisë. Tani Presidenti ka fuqi të mëdha në caktimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të cilët nga 17 sa kanë qenë, janë 15 anëtarë sepse është eliminuar gjykata ushtarake turke. Ndikimi i Presidentit në gjyqësor dhe prokuror shihet nga fakti se ai tani emëron anëtarët e **Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial**, numrin më të madh të tyre, të cilët propozojnë kandidatët e tyre në Gjykatën Kushtetuese të Turqisë. Kjo nënkupton se tani e tutje anëtarët që vijnë nga gjyqësori dhe sistemi prokurorial turk, do të jenë të përzgjedhurit e Presidentit. Këto amendamente, të cilat u miratuan me referendum, kanë qenë objekt i mbledhjes së 110 plenare të **Komisionit të Venecias**, e cila në mendimin e vet të miratuar më 11 mars 2017, në mënyrë shumë të ashpër dhe krejt profesionale ka dhënë vërejtjet e veta. Autori i parë i këtyre rreshtave, si anëtar me të drejta të plota dhe si përfaqësuesi i parë i Kosovës në **Komisionin e Venecias**, ka shprehur përkrahjen e parezervë ndaj mendimit të Komisionit dhe me keqardhje kujton reagimin mospërfillës të **delegacionit turk** ndaj çdo vërejtje të sinqertë dhe profesionale të këtij organi. Në veçanti ka rëndësi të theksohet reagimi i **delagacionit turk** me argument që thoshin se sistemit që po propozohej turk i qeverisjes modelohej sipas traditës dhe modelit amerikan presidencial, në ndërkohë që në të gjitha amendamentet shihet qartë prishja e balansit në mes të pushteteve dhe koncentrimit të pushtetit absolute në duart e **Presidentit të Turqisë**. U mor vesh, këto sugjerime dhe vërejtje fare nuk janë marrë parasysh nga establishmenti i Presidentit **Rexhep Taip Erdogan** në **Ankara.** Cf. EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION), *TURKEY: OPINION ON THE AMENDMENTS TO THE CONSTITUTION ADOPTED BY THE GRAND NATIONAL ASSEMBLY ON 21 JANUARY 2017 AND TO BE SUBMITTED TO A NATIONAL REFERENDUM ON 16 APRIL 2017*. Adopted by the Venice Commission at its 110th Plenary Session (Venice, 10-11 March 2017).Paragrafet: 114–119 ["Këshilli i Gjyqtarëve dhe Prokurorëve"]; 120 ["Këshilli i Shtetit"]; dhe 121-123 ["Gjykata Kushtetuese"].

e shoqatave të juristëve të praktikës. Një shumicë e dy të tretave të krejt anëtarëve të Asamblesë kërkohet për raundin e parë, kurse për të dytin një shumicë absolute. Në raundin e tretë shkojnë vetëm ata që në raundin e dytë kanë pasur më së shumti vota, kurse fiton për t'u bërë gjyqtar vetëm kandidati që merr shumicën e thjeshtë të votave. Presidenti i Republikës cakton tre anëtarë nga **Gjykata e Kasacionit**, dy tjerë nga **Këshilli i Shtetit** dhe nga një anëtar nga **Gjykata Ushtarake e Kasacionit** dhe **Gjykata e Lartë Administrative Ushtarake**. Kandidatët nga gjyqësori nominohen nga plenarja e këtyre gjykatave. Presidenti po ashtu cakton kandidatët e nominuar për çdo vend të ngelur vakant, të cilët nominohen nga **Këshilli i Lartë i Edukimit** nga radhët e profesoratit universitar. Dy nga këta duhet të jenë në lëmin e drejtësisë. Së fundi, Presidenti i cakton katër anëtarë të Gjykatës sipas diskrecionit të tij. Ata duhet të jënë nga mesi i administratorëve të profilit të lartë, jurist nga praktika, gjyqtarë dhe prokurorë të rangut të lartë, si dhe raportues të **GJKTr** me përvojë së pakut pesëvjeçare në shërbim.[22]

Sipas Kushtetutës së vitit 1982, **GJKTr** ka pasur kompetenca në shtatë fusha, kurse e teta iu është shtuar me amendamentet kushtetuese të vitit 2010 dhe ka të bëjë me **aneksin kushtetues**. Me këtë ndryshim të vitit 2010, më nuk mund të thuhet se **GJKTr** ka karakter elitist, ani se presidenti ka shumë ndikim në përzgjedhjen gjyqtarëve të saj, në veçanti pas amendamenteve të vitit 2017, të cilat kanë kufizuar kompetencën e **GJKTr** ndaj kontrollit kushtetues të dekreteve me fuqi ligjore të Presidentit (i cili tani përfaqëson pushtetin ekzekutiv). E thënë me fjalë të tjera, si pasojë e ndryshimeve të sistemit të qeverisjes, gjyqësia kushtetuese në **Turqi** ka ndërruar fizionominë e vet, nga një gjyqësi kushtetuese elitiste në një gjyqësi që pretendon të jetë popullore që më nuk mbron vlerat kushtetuese të një sistemi laik dhe republikan, por të një sistemi jolaik dhe jokemalist. Këto ndryshime të thella, një ditë mbase duhet të jenë objekt i një shkrimi tjetër lidhur me natyrën sistemit aktual kushtetues turk. Tani t'i kthehemi diskutimit për çështjen si më sipër, për llojet e juridiksionit dhe, për pasojë, për palët e autorizuara në gjyqësinë kushtetuese turke.

Kompetenca e parë e **GJKTr** është klasike **evropiane/kelzeniane** dhe ka të bëjë me të drejtën e saj për anulimin e ligjeve, dekreteve me fuqi ligjore, rregullave dhe akteve të tjera të **Asamblesë së Madhe Nacionale**. Me amendamentet e vitit 2017, iu është hequr e drejta për të ushtruar kontrollin e kushtetutshmërisë së dekreteve të Presidentit dhe, për pasojë, e drejta për anulimin e tyre në rast të kundërkushtetutshmërisë. Me këto amendamente e drejta për nxjerrjen e dekreteve me fuqi ligjore i takon Presidentit sepse tani e tutje përfaqëson pushtetin ekzekutiv në Turqi.[23]

Kompetenca e dytë e **GJKTr** ka të bëjë me **kontrollin incidental** të kushtetutshmërisë, i cili ngrihet pranë saj nga ana e gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm gjatë kohës sa vendosin për ndonjë rast (civil, penal apo administrative) apo mosmarrëveshje në mes të palëve.

Kompetenca e tretë ka të bëj me të drejtën e **GJKTr** për të vepruar si Gjykatë e Lartë, njëjtë siç ndodhë me shumicën e vendeve të botës ku gjykatat kushtetuese apo gjykatat supreme veprojnë si gjykatë lartë në rrethanat e caktuara dhe për veprat e caktuara. Veprimi i saj në këtë cilësi, pra veprimi si **Gjykatë e Lartë e Turqisë**, ndodhë atëherë kur duhet të konstatohet përgjegjësia e Presidentit të Republikës, Kryeministrit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave (Qeverisë), gjyqtarëve të **GJKTr** dhe të gjitha gjykatave të tjera të larta në vend, Prokurorit të Përgjithshëm**,** si dhe të anëtarëve dhe kryetarit të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial. Me amendamentet e vitit 2010, **GJKTr** ka marrë edhe disa kompetenca për të vepruar si Gjykatë e Lartë, përkatësisht për gjykimin e veprimeve të kryera

---

22 Cf. Neni 146.1 ["II. Gjykatat e Larta. A. Gjykata Kushtetuese"] i Kushtetutës së vitit 1982 (i amendamentuar më 12 shtator 2010 me Ligjin Nr. 5982).

23 Bazuar në analizën empirike të ekzekutimit në praktikë të këtij funksioni të Gjykatës, pra të kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë, në literaturën e shkencave politike autorët kanë ardhur deri te përfundimi se **GJKTr** ka shërbyer si një mekanizëm demokratizues i Turqisë sepse ka promovuar llogaridhënien horizontale të të gjitha levave të pushtetit, jo ruajtjen e hegjemonisë së saj si një instrument elitik shtetëror. Cf. lidhur me këtë në:Yasushi Hazama, "Hegemonic preservation or horizontal accountability: constitutional review in Turkey", fq. 425-440; Autorët tjerë, ndërkaq, kanë arritur deri te rezultatet e kundërta, pra se roli i **GJKTr** ka qenë kyc në ruajtjen e rolit hegjemonist të elitës shtetërore kundrejt të tjerëve. Këtë konkluzion, autorët e arrijnë duke analizuar ekzekutimin në praktikë të kompetencave tjera përveç asaj të kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë, siç janë shpërbërja dhe kontrolli i partive politike, kontrolli konkret i kushtetutshmërisë dhe kontrolli i kushtetutshmërisë së veprimit administrativ të shtetit turk. Cf. lidhur me këtë në: Ozbudun, *The Constitutional System of Turkey: 1876 to the Present*, 122-127.

nga zyrtarët e lartë shtetëror gjatë ushtrimit të detyrës së tyre zyrtare. Në këtë grup të zyrtarëve të lartë hyjnë: kryeparlamentari turk, shefit i shtabit të ushtrisë turke dhe komandantët e forcave të armatosura tokësore, detare dhe ajrore, si dhe komandantët e xhandarmërisë turke.

Kompetenca e katërt dhe e pestë e **GJKTr** kanë të bëjnë me partitë politike: e katërta i referohet të drejtës së saj për vendosur lidhur me shpërbërjen e partive politike, kurse e pesta me të drejtën për të vendosur lidhur me kontrollin raporteve financiare (kontabilitetin) të partive politike.

Kompetenca e radhës, e gjashta, i jep autorizim **GJKTr** për të vendosur lidhur me kushtetutshmërinë e vendimit të **Asamblesë së Madhe Nacionale** ose të ndonjë rregullative parlamentare që ka të bëjë me autorizimin për të proceduar me heqjen e imunitetit të një deputeti, humbjen e mandatit të deputetit si dhe lidhur me vendimet tjera të Asamblesë që kanë të bëjnë me heqjen e imunitetit parlamentar.

Kompetenca e shtatë e **GJKTr** nuk ka natyrë juridiksionale. Ajo është kompetencë krejtësisht e natyrës administrative dhe ka të bëj me të drejtën e saj për nominimin e njërit prej anëtarëve të vet për kryetar të **Gjykatës për Zgjidhjen e Konflikteve të Juridiksionit të Turqisë**. Kjo është kështu për shkak se në **Turqi** nuk ekziston një kompetencë e **GJKTr** për zgjidhjen e konflikteve për kompetencë në mes të organeve të shtetit, siç ekziston në të gjitha gjykatat kushtetuese të modelit evropian/kelsenian. Autorizimi për të zgjidhur konfliktet për kompetencë në Turqi i besohet një gjykatë të ndarë, e cila quhet si më sipër, dhe që ka në kompetencë të vete ekskluzive vendosjen lidhur me konfliktin për kompetencë në mes të organeve shtetërore turke. Kjo përvojë turke ndjek **modelin francez** dhe që është sanksionuar për herë të parë me Kushtetutën në fuqi të vitit 1982.[24]

Këto kompetenca si më sipër janë rregulluar me nenet 69, 85, 148, 152 dhe 158 të Kushtetutës. Me amendamentet e vitit 2010 në nenin 148, i cili bën fjalë për funksionet dhe autorizimet e **GJKTr**, është shtuar edhe fjalia që thotë se ajo ka kompetencë për të vendosur edhe për **ankesat individuale kushtetuese**, si dhe një paragraf tjetër që specifikon qartë se çka është objekt i kontrollit kushtetues në rastet e procedurave sipas **ankesës kushtetuese**. Sipas këtij paragrafi, **ankesa kushtetuese** "[…] mund të ushtrohet vetëm pas shterjes së të gjitha mjeteve juridike të garantuara nga rendi juridik turk dhe për objekt të vetin ka mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore nga **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut** (KEDNJ) të cilat janë të garantuara me Kushtetutë e që janë cenuar nga ana e autoriteteve publike". Objekt i kërkesës në një aneks kushtetuese, sipas formulimit të këtij paragrafi, nuk mund të jenë çështjet që janë objekt vendosje në procedurat ligjore pranë gjykatave dhe organeve tjera. Kjo është refleksion i **parimit të subsidiaritetit** të punës së **GJKTr** dhe parimit të shterjes së mjeteve juridike si parakusht për lejueshmërinë e një ankese kushtetuese.

Në literaturë, me të drejtë është vërejtur se ky paragraf, me të cilin është futur aneksi kushtetues në sistemin juridik – kushtetues turk, reflekton në mënyrë të hapur synimin e **Turqisë** për të vënë në jetë standardet e **Strasburgut** sa i përket lirive dhe të drejtave të njeriut, nisur nga fakti se ky vend ka pasur një përvojë të hidhur me **Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut** (GJEDNJ) ku shumica e rasteve kundër **Turqisë** janë fituar nga shtetasit turq, gjë që ka kompromet uar imazhin e vendit në **Evropë** dhe më gjerë.[25] Në fakt, vetë hartuesit e këtij amendamenti, anëtarët e **GJKTr**, në arsyetimin e tyre dërguar **Komisionit të Venecias** kishin thënë se për synim kishin pasur të zvogëlonin numrin e rasteve të iniciuara në **GJEDNJ** kundër Turqisë për shkelje të të drejtave të

[24] Cf. Neni 158 ["**Gjykata e Konflikteve të Juridiksionit**"] i Kushtetutës.

[25] Engin Yildirim, "Individual application to the Turkish Constitutional Court as a case of constitutional transfer". *Global Constitutionalism* Vol. 5 Issue 2 (July 2016) fq. 269 – 294. Në këtë studim empirik, autori flet gjerësisht dhe vërteton konstatimin si më sipër që thotë se transferi juridik i **aneksës kushtetuese** në **Turqi** ka qenë pasojë imediate e situatës së vendit me rezultatet jashtëzakonisht negative të dala nga rastet e ngritura nga shtetasit turq në **Gjykatën e Strasburgut**, si dhe për synimin turk për të përmirësuar këtë imazh të keq në **Evropë** dhe më gjerë.

njeriut të shtetasve turq.[26] Duhet theksuar këtu me këtë rast se roli i **Komisionit të Venecia**s dhe i **GJEDNJ** ka qenë krucial në transplantimin e idesë së ankesës kushtetuese në sistemin kushtetues turk.[27]

Të gjitha procedurat, organizimi i brendshëm dhe çështjet tjera të punës së **GJKTr** normohen me aktin organik, i njohur si **Ligji Nr. 6216 mbi Themelimin dhe Rregullat e Procedurës në Gjykatën Kushtetuese** (2011).[28] Ky akt nuk përcakton juridiksion shtesë për **GJKTr**, njëjtë siç ka qenë rasti edhe me aktet tjera organike të vitit 1962 e këndej, të cilat kanë normuar të njëjtën materie organike.

8.2. Izraeli

Historia kushtetuese e **Izraelit** është unike. Ajo dallon skajshmërisht nga historia kushtetuese e secilit vend të diskutuar deri këtu: një vend i krijuar pas Luftës së Dytë Botërore pas një gjenocidi të tmerrshëm kundër hebrenjve të kryer nga **Gjermania e Hitlerit**, i kaluar në heshtje në mënyrë të pabesueshme në dy anët e Atlantikut në ndërkohë që po kryhej, Izraeli akoma përballet me luftën për mbijetesë në atë pjesë të botës. Si katalizator për formimin e tij në aspektin formal shërbeu një rezolutë e **Kombeve të Bashkuara**, Rezoluta nr. 181 (1) e datës 29 nëntor 1947, e cila parashikonte ndarjen e **Mandatit të Palestinës**, krijimin e një shteti hebre dhe një tjetri arab dhe vënien nën regjim special ndërkombëtar të qyteteve të **Jersulemit** dhe **Betlehemit.**[29]

Që nga fillim, Izraeli u ndesh me një refuzim të tërësishëm të vendeve arabe, fqinjëve të vet me të cilët rrethohet, ndaj jetësimit të kësaj rezolute dhe krijimit të shtetit të ri izraelit. Nisi lufta në mes të arabëve dhe izraelitëve, e cila akoma vazhdon me **Palestinën** si simbol dhe instrument i konfliktit të përgjithshëm arabo-izraelit. Derisa në luftën e parë arabo-izraelite (1948), bashkësia ndërkombëtare nuk kërkoi zbatim të ligjit ndërkombëtar, por zbatim në mënyrë ekskluzive të ligjit të brendshëm izraelit, në luftën e dytë arabo-izraelite (1967), e njohur si **Lufta Gjashtëditëshe**, fitimet e gjera territoriale izraelite nuk patën mundësi të kenë statusin kushtetues të një territori të brendshëm ku vlejnë ligjet civile të kohë të paqes: bashkësia ndërkombëtare në vazhdimësi ka kërkuar dhe kërkon që Izraeli të zbatojë ligjin ndërkombëtar, të drejtën ndërkombëtare të luftës, e cila e detyron okupuesin që të respektojë ndarjet e mëparshme administrative, shtetësinë dhe të drejtat civile që kanë qenë në fuqi në territorin e okupuar para marrjes me dhunë të tij nga ana e Izraelit. Ai territor i ka takuar disa vendeve arabe: **Jordanisë** (Jerusalami Lindor dhe Bregu Perëndimor) **Sirisë** (Rrafshnalta e Golanit) dhe **Egjiptit** (Rripi i Gazës dhe Sinai).[30]

---

[26] Mendimi i **Komisionit të Venecias** ka qenë shumë pozitiv ndaj këtij amendamenti kushtetues që fuste në sistem **aneksën individuale**. Ankesa kushtetuese, megjithatë, u fut me amendamentet e vitit 2010, me efekt nga 22 shtatori i vitit 2012. Cf. EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION), *OPINION ON THE DRAFT CONSTITUTIONAL AMENDMENTS WITH REGARD TO THE CONSTITUTIONAL COURT OF TURKEY.* Opinion 296/2004. CDL-AD(2004)024 (Strasbourg, 29 June 2004). Paragrafet 31, 35 dhe konkluzionet; dhe
EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION), *OPINION ON THE LAW ON THE ESTABLISHMENT AND RULES OF PROCEDURE OF THE CONSTITUTIONAL COURT OF TURKEY*. Adopted by the Venice Commission at its 88th Plenary Session (Venice, 14-15 October 2011). Opinion No. 612 / 2011. CDL-AD(2011) 040 (Strasbourg, 18 October 2011). Paragrafet: 1-2, 7, 8, 11, 101-104.

[27] Engin Yildirim, "Individual application to the Turkish Constitutional Court as a case of constitutional transfer", fq. 278-282.

[28] *LAW ON THE ESTABLISHMENT AND RULES OF PROCEDURE OF THE CONSTITUTIONAL COURT OF TURKEY* (LAW NO: 6216, ADOPTED 30 MARCH 2011). Në Internet: https://www.anayasa.gen.tr/baslar2.htm (shikuar në gusht 2017).

[29] Nga konstitutcionalistët e njohur hebrenj, për një kohë të caktuar kjo rezolutë është cilësuar si një lloj ligji organik dhe si burim i të drejtës kushtetuese izraelite. Ky pozicion tani është braktisur. Cf. për këtë në Melville B. Nimmer, "The Uses of Judicial Review in Israel's Quest for a Constitution". *Columbia Law Review* Vol. 70, No. 7 (1970), fq. -1217-1260 në fq. 1240-1246.

[30] Me nënshkrimin e **Marrëveshjes së Paqes me Egjiptin** në **Camp David** (Washington D.C., SHBA) më 17 shtator 1978, vitin në vijim, **Izraeli** u tërhoq nga **Sinai** dhe abrogoi sundimin ushtarak në **Bregun Perendimor** dhe **Rripin e Gazës**, duke instaluar administrimin civil në këto zona, të okupuara në vitin 1967, dhe, në të njejtën kohë, aneksoi **Rrafshnaltën e Golanit** dhe **Jerusalemin Lindor**.

Kjo nuk do të thotë se **Izraeli** ka respektuar ligjin e luftës apo se ka respektuar rendin juridik kushtetues që ka qenë në fuqi në këto territore para okupimit të tyre më 1967.[31] Ajo çfarë do të thotë konsiston në faktin se **Izraeli**, që nga themelimi i tij si shtet në vitin 1948, ka pasur një jetë të vështirë, një luftë për ekzistencë fizike, gjë e cila e ka detyruar që për shkaqe sigurie të luftojë pandërprerë për fitimin e rripave territorialë përreth territorit fillestar që ia ka takuar me rezolutën e Kombeve të Bashkuara nr. 181 (1) si më sipër, me qëllim të neutralizimit të rrezikut permanent ushtarak arab.[32] Kjo situatë permanente, e cila akoma vazhdon edhe sot, ka prodhuar një rend kushtetues paradoksal në **Izrael,** një situatë juridiko-kushtetuese ku vështirë se mund të thuhet me saktësi se ku fillon ligji ndërkombëtar e ku ai i brendshëm i Izraelit. Kjo situatë, për më tepër, ka shkaktuar mospasjen e një kushtetuese të shkruar izraelite, por të një mori ligjesh, të njohura si **ligjet bazike** ("Basic Laws "), sipas emërtimit të përdorur nga gjermanët për tekstin e tyre kushtetues pas Luftës së Dytë Botërore.[33]

U emërtuan ligje bazike sepse, si të tilla, normojnë një territor që nuk ka kufij dhe nuk di se cilët janë shtetasit e vet realë, cila është natyra e shtetit, raporti i tij me fenë, si dhe statusi dhe pozita e të drejtave të njeriut. Në këtë vend asnjëherë nuk ka pasur konsensus lidhur me këto çështje nga frika se, çdo kornizim

---

31 Në këtë luftë, e njohur si **Lufta Gjashtë Ditësh**, forcat ushtarake të **Egjiptit, Sirisë** dhe **Jordanisë** në një përpjekje për të zhdukur **Shtetin e Izraelit**, kanë pësuar fiasko të shpejtë në terrenin ushtarak nga një kundërofensivë ushtarake izraelite. Kjo pati për pasojë dorëzimin e shpejt të tri vendeve arabe dhe humbjen e menjëhershme të territoreve të sipërcekura: **Rrafshnaltën e Golanit**, **Jerusalemin Lindor** dhe pjesë të caktuara në **Bregun Perëndimor** dhe në **Rripin Gaza.** Cf. për detajet e kësaj lufte dhe humbjet territoriale të vendeve arabe në librin e shkëlqyer, në të cilin jepen edhe aspektet historike të origjinës së konfliktit arabo-izraelit ndërmjet dy luftëraeve botërore dhe mënjëherë pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, të Michael B. Oren, *Six Days of War: June 1967 and the Making of the Modern Middle East* (Presidio Press: New York NY, 2003).

32 Hapësira e tërësishme e **Izraelit** sot është 22, 145 km katror. Kjo përfshinë **Jerusalemin Lindor** dhe **Rrafshnaltën e Golanit** (dy këto kanë hapsirë prej 1, 154 km katror). Territori tokësor është 21, 671 km katror.
Me **Marrëveshjen e Paqes me Jordaninë** (26 tetor 1994) një këmbim territoresh ka ndodhur në zonën **Arava Jugore** dhe **Fushës Bet She'an**.
Jeruslaemi Lindor është aneksuar më 1967 pas **Luftës Gjashtë Ditësh**. Nga ky vit territori në fjalë është futur në kuadër të kufijve formal administrativ të **Shtetit të Izraelit**. Në qershor 1967, menjëherë pas mbarimit të Luftës Gjashtëditësh, **Izraeli** aneksoi 70.000 ha tokë në lindje të **Jerusalemit Perëndimor**. Ky aneksim përfshinte 6.000 ha të **Jerusalemit të Jordanisë** dhe 28 qytete dhe fshatra të **Bregut Perëndimor** të cilat paoshtu kishin qenë nën juridiksionin e Jordanisë. Me këtë territori i Qytetit të Jerusalemit u rrit për tri herë, duke u bërë kështu më i madhi qytetat në Izrael. Me aneksim, 69, 000 banorë palestinez u futën nën juridiksionin izraelit me statusin e banorit pa të drejta qytetare në Shtetin e Izraelit. E vetmja e drejtë e tyre ka qenë lejimi për të votuar në zgjedhjet për **Parlamentin e Palestinës** në vitit 1996 dhe 2006 e tutje.
Në ndarjen formale administrative të **Shtetit të Izraelit**, **Rrafshnalta e Golanit** iu është bashkangjitur në vitin 1981, bazuar në **Ligjin mbi Rrafshnaltën e Golanit**, nxjerrë më 14 dhjetor 1981. Para vitit 1967, ky territor i ka takuar **Sirisë.** Në vititn 1973, disa pjesë të këtij territori i janë kthyer **Sirisë**.

33 Përveç si më sipër, Izraeli ka mbajtur edhe territoret tjera shtesë, të cilat me Rezolutën 181 (1) të Kombeve të Bashkuara parashikohej që duhet të jenë territor arab për themelimin e Shtetit Arab në këtë pjesë të botës. Me shtet arab sot nënkuptohet Shteti i Palestinës. në këto territore hyjnë **Bregu Perëndimor**, i njohur si **Judea dhe Samaria**, me një sipërfaqe prej 5, 651 km katror. Pas **Luftës Gjashtë Ditëshe**, **Izraeli** ka mbajtur **Judean, Samarinë** dhe **Rripin e Gazës**, si dhe **Rrafshanltën e Golanit** dhe **Sinain**. Kombet e Bahskuara miratuan një rezolutë, Rezolutën 242 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, me të cilën ftuan Izraelin që të kthejë territoret e fituara me dhunë në këmbim të paqes. E kundërt me situatën e vitit 1949, kur Kombet e Bashkuara i njohën si territore sovrane të Izraelit ato që ky vend i kishte fituar më dhunë në Luftën e Parë Arabo-Izraelite të nisur një ditë pas shpalljes së pavarësisë së vet, Rezoluta 242 shpalli se territoret e fituara në vitin 1967 konsiderohen territore të okupuara. Për pasojë, Kombet e Bashkuara kërkuan nga Izraeli që të sillet ndaj tyre dhe popullsisë që banonte aty sipas të drejtës ndërkombëtare mbi territoret e okupuara. Kjo nënkuptonte një sërë ndalesash për **Izraelin,** siç janë: ndalimi i çfarëdo ndryshimit në statusin administrativ të territorit të ekupuara; ndalimin e ndërtimit të vendbanimeve të reja dhe rrugëve; ndalimin e shrytëzimit të resurseve natyre në territoret e okupuata; ndalimin e vendosjes së dënimit kolektiv ndaj popullësisë së okupuar për shkak të mosdëgjimit të saj dhe kështu me radhë. Në gusht të vitit 2005, **Izraeli** vendosi që të tërhiqet nga **Rripi i Gazës** dhe, me një lëvizje të njëanshme, lëshoi vendbanimet në këtë zonë, duke i dhënë fund okupimit ushtarak që ishte vënë aty më 1967. Zona e **Rripit të Gazës**, e cila kishte qenë nën sundimin izraelit gjatë viteve 1967-2005, përfshinë një hapsirë prej 362 km katror. Cf. Suzie Navot, *The Constitutional Law of Israe*l (Kluwer Law International: The Netherlands, 2007) fq. 25-27 (përfshirë fusnotat).
Arsyeja për një qasje të tillë ka qenë kjo: **Gjermania** pas **Luftës së Dytë Botërore** nuk e quajti kushtetutë aktin e vet juridik më të lartë me bindjen se një ditë do të ribashkohej me pjesën lindore që ishte nën sundimin sovjetik, ashtu që vetëm pas bashkimit gjerman vendi mund të cilësohej si një vend sovran me një kushtetutë integrale e cila do të reflektonte vullnetin e krejt kombit.

në një tekst kushtetues i jetës socio-politike, ekonomike dhe kulturore do të përjashtonte nga loja ata që nuk jetonin në Izrael në kohën e themelimit të shtetit në vitin 1948. Për këtë arsye, **Izraeli** ndoqi rrugën e kushtetutëbërjes parciale dhe emergjente, gjë e cila diktohej nga rrethanat në të cilat u themelua dhe u zhvillua shteti izraelit në vitet e para pas shpalljes së pavarësisë së vet më 14 maj 1948.[34]

Në një situatë të tillë, sigurimi i supremacisë (epërsisë) së kushtetutës nuk kishte asnjë vlerë dhe asnjë apel mobilizues për qytetarin dhe institucionet e **Izraelit**. Në këtë fillim, as gjykatat izraelite nuk kishin ndonjë ide më konkrete se cilat norma të ligjeve bazike paraqisnin apo sanksiononin një rend më superior krahasuar me rendet tjera juridike që sanksionoheshin me po ato ligje, përkatësisht nuk mund të dinin se cili rend juridik ishte më i ulët se rendi tjetër (imagjinar) superior kushtetues. Kjo gjendje buronte nga shkaku se ligjet mund të nxirreshin me një shumicë të kualifikuar, mirëpo kjo nuk nënkuptonte se, në parim, ndryshimi i tyre nuk mund të bëhej me një shumicë të thjeshtë, njëjtë siç bëhej ndryshimi i ligjeve tjera të nxjerra nga **Knesset**-i (Parlamentit i Izraelit). Kjo gjendje i dedikohet, sipas konstitucionalistëve izraelitë, dështimit të **Izraelit** për të miratuar një kushtetutë integrale dhe qasjes së përqafuar me **Rezolutën Harari** në vitin 1950, gjendje që buronte, siç u tha më sipër, nga fakti së në shoqëri asnjëherë nuk u krijua një konsensus sa i përket natyrës së shtetit, vendit dhe pozitës së të drejtave të njeriut, si dhe lidhur me çështjet tjera themelore të shtetndërtimit.[35] Sqarimi i këtij konteksti ka rëndësi të madhe për të kuptuar gjendjen aktuale të kontrollit kushtetues si dhe perspektivat e konstitucionalizmit në këtë vend.

Dokumenti i parë kushtetues i Izraelit është **Deklarata e Pavarësisë**. Kjo deklaratë krijoi institucionet qendrore të qeverisjes në **Izrael** – legjislativin, ekzekutivin dhe gjyqësorin, në pritje të nxjerrjes së kushtetutës së re të vendit. Kushtetuta, sipas Deklaratës, do të duhej të nxirrej jo më larg se 1 tetor 1948 nga një asamble kushtetuese, e zgjedhur nergut për këtë qëllim. Kjo nuk ndodhi, megjithatë, si pasojë e fillimit të luftës së parë arabo-izraelite qysh ditën e nesërme pas shpalljes së pavarësisë së Izraelit. Kjo u bë nga fakti se arabët nuk pranuan, në asnjë mënyrë, formimin e **Izraelit** si shtet, pozitë që në thelb nuk ka ndryshuar që nga ajo kohë (me përjashtim të **Jordanit** dhe **Egjiptit,** të cilët njohën në ndërkohë ekzistencën e Izraelit si komb dhe si shtet). Për këtë arsye, zgjedhjet për **Asamblenë Kushtetuese të Izraelit** u shtynë për kohë të pacaktuar. Ato u mbajtën vetëm në janar të vitit në vijim. Kur u mbledh Asambleja Kushtetuese, ajo nxori një akt tjetër juridik, jo kushtetutën, përkatësisht nxori **Ligjin për Tranzicionin**. Me këtë ligj u ndryshua emri i organit përfaqësues izraelit, i cili tani e tutje do të quhet **Knesset** (Parlament). Ky organ, i pari, supozohej se do të nxirrte një kushtetutë të re për vendin. Këtë nuk e bëri. Ajo çfarë bëri **Knesseti i Parë** vitin në vijim, më 13 qershor 1950, ishte një deklaratë e njohur në historinë kushtetuese izraelite si **Deklarata Harari.**[36] Ideja e kësaj rezolute, e emërtuar sipas sponsorit të saj, një deputet i **Knessetit të Parë**, ka qenë kjo: kushtetuta e vendit do të nxirrej në mënyrë graduale, kapitull për kapitull, në formë të ligjeve bazike për secilin kapitull, ashtu që në fund të gjitha ligjet bazike do të integroheshin në një tekst të vetëm kushtetues.

Deklarata nuk sqaroi askund nëse ligjet bazike do të kishin një vlerë tjetër juridike, më superiore (më të lartë) se ligjet e zakonshme, të cilat do t'i nxirrte **Knessseti** në të ardhmen. Asnjë fjalë nuk tha nëse këto ligje bazike do të mund të shërbenin si bazë juridike për gjykatat izraelite për të shpallur të pavlefshëm dispozitat tjera juridike që binin në kundërshtim me to. Sikundër dihet, dy kritere duhen plotësuar për të ekzistuar kontrolli gjyqësor i kushtetutshmërisë së normës juridike: e para, duhet të ketë një normë

---

[34] Amos Shapira, "Judicial Review Without a Constitution: The Israeli Paradox". *Temple Law Quarterly*, Vol. 56 Issue 2 (1983) fq. 405-462 në 408-410.

[35] Cf. më shumë për këtë në Aeyal M. Gross, "The Politics of Rights in Israeli Constitutional Law" Israel Studies Vol. 3 Number 2 (Fall 1998) fq. 80-118; Daphne Barak-Erez, "BROADENING THE SCOPE OF JUDICIAL REVIEW IN ISRAEL: BETWEEN ACTIVISM AND RESTRAINT". *Indian Journal of Constitutional Law* Vol. 8 Number 3 (2009) fq. 118-137.

[36] Ani se paraqet dokumentin e parë kushtetues të **Izraelit** të pavarur, Deklarata asnjëherë nuk u njoh si një akt me fuqi normative, as nga **Gjykata Supreme e Izraelit** (**GJSIz**) e as nga doktrina juridike izraelite. Cf. më shumë në Robert A. Burt, "Inventing Judicial Review: Israel and America" (1989). *Faculty Scholarship Series.* Paper 791. Në internet:http://digitalcommons.law.yale.edu/fsspapers/791(shikuar në shtator 2017); Robert A. Burt, "Inventing Judicial Review: Israel and America" (1989). *Faculty Scholarship Series.* Paper 791. Në internet: http://digital commons.law.yale. edu/fss_papers/791 (shikuar në shtator 2017).

kushtetuese e cila ka fuqi më të lartë (më sipërore) se çdo normë tjetër juridike në vend; dhe, e dyta, duhet të ekzistojë një organ gjyqësor i mandatuar me kushtetutë, ligj apo përmes precedentit (praktikës gjyqësore) për të ushtruar këtë kontroll të kushtetutshmërisë. Në rastin e **Izraelit**, në fillim të krijimit të praktikës gjyqësore në lëmin e kontrollit të kushtetutshmërisë së normave ligjore, asnjëri nga këto kritere nuk ishin plotësuar.[37] Për një kohë të gjatë, gjyqësori izraelit pati rezerva të theksuara ndaj ushtrimit të kontrollit gjyqësor. Ato rezerva bazoheshin në arsye historike (vendi modelohej sipas sistemit juridik britanik ku supremacia e parlamentit paraqitet si diçka absolute), juridike (mungesa e një dispozite kushtetuese apo ligjore që do t'i jepte të drejtë gjyqësorit për të ushtruar kontroll të kushtetutshmërisë) dhe politike (rreziku nga politizimi i gjyqësorit).[38]

Gjendja si më sipër, me kalimin e kohës nisi të ndryshojë. Ka qenë gjyqësori izraelit, jo ligjvënësi apo nga teoria juridiko-kushtetuese, ai që ka gjetur rrugët për të instaluar kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve, në mënyrë të njëjtë siç kishte ndodhur me SHBA-të në rastin e njohur **Marbury v Madison** (1803): Kushtetuta e SHBA-ve bënte fjalë për gjyqësorin dhe juridiksionin e tij **grosso modo**, por asnjëherë nuk mund të thuhet se teksti kushtetues parashikonte një gjë të tillë. Ka qenë guximi i **John Marshall**-it dhe, shumë kohë para tij, vetë guximi i baballarëve të kombit amerikan, të cilët në **Letrat e Federalistit** (1788) arsyetuan me të drejtë autorizimin e degës së gjyqësorit për të bërë kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së **Kushtetutës së SHBA**-ve. Edhe në rastin e Izraelit, kanë qenë dy aspekte në të cilat është ankoruar arsyetimi i **GJSIz** me rastin i themelimit të praktikës së kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve: **klauzola e rrënjosur** (angl.: "entrenchmenet clause") dhe **shumica e caktuar parlamentare**. Dy këto aspekte janë reflektuar në aktivitetin ligjvënës të **Knessetit**, duke i mundësuar **GJSIz** themelimin e praktikës së kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve, njëjtë siç kishte ndodhur në SHBA me rastin **Marbury v Madison**, pa pasur një autorizim shprehimor në tekstin kushtetutës. Të shohim më nga afër se për cilat aspekte është fjala. Para se të nisim këtë, shënojmë se në dy rastet, ka qenë **GJSIz** ajo që ka hapur rrugën e kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë së ligjeve, bazuar në riinterpretimin e saj të klauzolës së rrënjosur dhe konceptit të shumicës së caktuar parlamentare. Këto dy koncepte i kanë shërbyer **GJSIz** si bazë mbështetëse për arsyetimin e sigurimit të supremacisë (epërsisë) së normave të caktuare ligjore, duke ua njohur atyre karakterin kushtetues, norma të cilat gjinden sot e kësaj dite të shkapërderdhura nëpër ligjet e ndryshme bazike të **Knessetit**.[39]

Aspekti i parë, **klauzola e rrënjosur** nënkuptonte se disa dispozita të ligjeve bazike nuk mund të cenoheshin pa pasur pasoja kushtetuese sepse mbronin disa vlera shumë më të larta se vlerat që mbroheshin përmes ligjeve të tjera të zakonshme. Nuk kishte asnjë rëndësi fakti se vetë këto ligje bazike mund të kishin qenë të miratuara me një shumicë të thjeshtë. Në këtë grup të ligjeve bazike më të rëndësishme, me të cilat mbroheshin vlera më të larta kushtetuese se të tjerat, bënin pjesë **Ligji Bazik: Dinjiteti Njerëzor dhe Liria (1992)**[40] dhe **Ligji Bazik: Liria e Profesionit** (1992).[41] Dy këto ligje janë amendamentuar në vitin 1994.

---

37 David Kretzmer, "Judicial Review of Knesset Decisions". *Tel Aviv University Studies in Law* Vol. 8 (1988) fq. 95- 155 në fq 105-107.

38 Ibid. fq. 99-107.

39 Ka rëndësi të kuptohet se **GJSIz** ka dy role: në rolin e parë, ajo paraqitet si gjykatë e shkallës së fundit për aneksat kundër vendimeve të dhëna nga gjykatat e qarkut në Izrael dhe, për pasojë, vendos në çështjet civile, adiministrative dhe penale.; në rolin e dytë vendos si **Gjykatë e Lartë e Drejtësisë** (**GJLDIz**) lidhur me peticionet kundër gjykatave dhe autoriteteve shtetërore dhe, që nga rasti **United Mizrachi Bank v. Migdal Cooperative Village**, ka të drejtën e ushtrimit të kontrollit kushtetues të normave. Për këtë do të flitet në vijim. Rasti si më sipër ka ardhur në Gjykatë Supreme përmes rolit të parë, pra sipas një ankese të ushtruar nga fshatarët që pohonin se një ligj u cenonte të drejtën e tyre të pronës.

40 *Basic Law: Human Dignity and Libery* (1992). (Unofficial translation by Dr. Susan Hattis Rolef). Në internet: http://knesset.gov.il/laws/special/eng/BasicLawLiberty.pdf (shikuar në gusht 2017).

41 *Basic Law: Freedom of Occupation* (1994). Në Internet http://www.med-media.eu/ëp-content/uploads/2015 / 08/kns13basiclaw_occupation_eng-1.pdf (shikuar në gusht 2017).

Aspekti tjetër kishte të bënte me shumicën e caktuar parlamentare si bazë për shfuqizim të çdo ligji që miratohej në kundërshtim me këtë shumicë të kërkuar. Këtu kemi të bëjmë vetëm me anën procedurale, përkatësisht me mospasjen e një shumice të caktuar parlamentare që shërbente si bazë për shfuqizim të ligjit të miratuar në kundërshtim me këtë shumicë të kërkuar parlamentare. Kjo klauzolë, **klauzola e rrënjosjes**, për herë të parë u parashikua me **Ligjin Bazik: Knesseti (1958).**[42] Klauzola e rrënjosjes nuk duhet të përzihet me **klauzolën e kufizimit** ("limitation clause"), e cila ka të bëj me anën substanciale të ligjit. Ana substanciale si shkak për shpallje si jo kushtetues të një norme ligjore ka lindur më vonë, në vitin 1992, kur u nxorën dy ligjet e sipërcekura të vitit 1992. Me këto dy ligje disa vlera kushtetuese u cilësuan si të një natyre më superiore (sipërore) krahasuar me vlerat tjera që mbroheshin me legjislacionin e rregullt ashtu që çdo ligj i miratuar në kundërshtim me to konsiderohej si jo kushtetues.

Nxjerrja e këtyre dy ligjeve në literaturë u cilësua si **revolucion kushtetues**, koncept që lidhet ngushtë me ish kryetarin e Gjykatës Supreme të Izraelit **Aharon Barak.**[43] Deri në rastin e njohur si **United Mizrachi Bank v. Migdal Cooperative Village** (1995), megjithatë, nuk ka qenë e qartë nëse ligjet bazike kishin një status supra legal, përkatësisht një status të tekstit juridik-kushtetues në krahasim me ligjet tjera. Përveç rasteve kur ligjet bazike përmbanin klauzolën e rrënjosjes, me të cilën vetë përcaktonin një status superior kushtetues krahasuar me ligjet tjera, ligjet bazike nuk konsiderohej se kanë ndonjë status më superior legal, ani se ligjet e vitit 1992 si më sipër sanksionuan disa vlera kushtetuese duke i vënë sipër vlerave të tjera që mbroheshin me ligjet e rregullta të nxjerra nga Knesseti. Kjo ndryshoi, siç do të shihet, me vendimin e sipërcekur të vitit 1995. T'i kthehemi tani gjendjes para vitit 1992, përkatësisht para vitit 1995.

Në nenin 4 ["Sistemi Zgjedhor"] të **Ligji Bazik: Knesseti**, aktualisht në fuqi, parashikon si vijon:

"Knesseti krijohet në zgjedhje të përgjithshme nacionale, të drejtpërdrejta, të fshehta, të barabarta dhe proporcionale. Ky nen mund të ndryshohet vetëm nga shumica e anëtarëve të Knessetit".

Sikundër shihet, në fjalinë e fundit sanksionohet **klauzola e rrënjosur**, e cila nuk lejon ndryshimin e kësaj dispozite veçse përmes një shumice absolute të të gjithë anëtarëve të parlamentit izraelit. Kur u nxor kjo dispozitë, gjyqësori nuk pa ndonjë ndryshim me dispozitat e ligjeve të zakonshme të nxjerra nga **Knesseti.** Kjo sepse, që nga **Deklarata Harari**, qe pranuar në mënyrë të qartë supremacia (epërsia) e parlamentit, i cili në mënyrë graduale mund të nxirrte disa ligje bazike, të cilat një ditë në të ardhmen, siç besohej, do të bëheshin kushtetutë e shkruar e këtij vendi. Derisa atëherë, të gjitha ligjet, bazike ose jo, do të gëzonin një status të njëjtë dhe mund të ndryshoheshin dhe shfuqizoheshin në tërësi sipas vullnetit të vetë nxjerrësit të tyre – **Knessetit**. Kjo gjendje ndryshoi më 1969, me vendimin e njohur si **Bergman v Minister of Finance** (1969).[44]

Esenca e vendimit ishte kjo: një ligj izraelit për financimin e partive politike i kohës lejonte që të financoheshin vetëm partitë parlamentare, duke ua mohuar një gjë të tillë partive politike dhe subjekteve të tjera të reja, të cilat nuk kishin status të partive parlamentare. **GJSIz**, pa vendosur fare lidhur me atë nëse çështja mund të ishte e gjykueshme, pra pa vendosur nëse kishte juridiksion për të vendosur lidhur me të, hyri në meritat e rastit duke ia njohur aplikuesit, **Dr. Aaron Bergman,** të drejtën dhe duke e urdhëruar **Knessetin** që të përmirësonte ligjin për financim të partive politike sipas udhëzimeve të nenit 4 si më sipër të **Ligjit Bazik**: **Knesseti**. Kjo u bë sepse, sipas **GJSIz,** një qasje e tillë e ligjit për financimin e partive politike cenonte barazinë e palëve në zgjedhjet nacionale, duke i vënë në pozitë të pabarabartë

---

42 *Basic Law: the Knesset* (1958). Në internet: http://knesset.gov.il/laws/ special/ eng/ BasicLaw TheKnesset.pdf (shikuar në gusht 2017).

43 Aharon Barak, "A Constitutional Revolution: Israel's Basic Laws". *Faculty Scholarship Series.* Paper 3697 (1993). Në Internet: http://digitalcommons.law.yale.edu/fss_papers/3697 (shikuar në gusht 2017).

44 Për refuzimin e **GJSIz** për të ndërhyrë në punët e **Knesset**-it, duke respektuar fuqishëm supremacinë (epërsinë) e tij, si dhe për arsyet historike të refuzimit të saj për një qasje të tillë për dy dekada me radhë, cf. shkrimin e detajuar hulumtues që mbështetet në precedentet gjyqësore të kohës, David Kretzmer, "Judicial Review of Knesset Decisions", fq. 96-107.

partitë apo subjektet që nuk kishin vende në parlamentin e kaluar. Ky ligj, megjithatë, nuk i jepte **GJSIz** të drejtën për të ushtruar kontrollin e kushtetutshmërisë së tij. As ligjet tjera bazike apo ligjet tjera të zakonshme nuk ia njihnin asaj një të drejtë të tillë. Nga kjo del se me këtë vendim, **GJSIz**, njëjtë si në rastin **Marbury v Madison** në SHBA, ia ka njohur vetes një të drejtë që fare nuk ka qenë e parashikuar me asnjë ligj bazik sektorial apo me ndonjë ligj tjetër, pra të drejtën për kontroll të kushtetutshmërisë së ligjeve.

Përveç përvetësimit për vete të kësaj të drejte, vendimi i mësipërm i **GJSIz** nuk flet asnjë fjalë lidhur me supremacinë (epërsisë) substanciale (materiale) të normave të caktuara të ligjeve bazike sektoriale, të cilat do të mund të zbatoheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë si norma supreme (më të larta) se normat e ligjeve tjera. Kjo rrethanë, pra mospasja e një autorizimi shprehimor kushtetues për të ushtruar kontrollin e kushtetutshmërisë, ka bërë që **GJSIz** të vendosë vet në mënyrë autonome se cilat raste do t'i konsiderojë si të gjykueshme e cilat jo, duke u përmbajtur deri në maksimum në vendimmarrjen e saj që kishte të bënte me shfuqizimin legjislacionin të **Knessetit**. Kjo gjendje ndryshoi më 1992, kur u nxorën dy ligjet si më sipër,[45] kurse më 1995 radikalisht u qartësua jo vetëm e drejta e gjykatave të **Izraelit** për kontroll gjyqësor të kushtetutshmërisë së ligjeve, por edhe statusi i ligjeve bazike të vitit 1992 dhe i krejt ligjeve të tjera bazike që mund të binin ndesh me këto dy ligje.

Ky ndryshim doli nga shkaku se tani, përveç bazës së nenit 4 të **Ligjit Bazik: Knesseti,** normat e këtyre dy ligjeve përcaktuan në mënyrë të qartë superioritetin (epërsinë) e tyre kushtetuese kundrejt çdo ligji tjetër ashtu që, për pasojë, lëndimi i tyre përbënte shkak të vlefshëm juridik për ushtrim të kontrollit të kushtetutshmërisë. Pra, nuk flitej më për cenim të procedurës, por të vetë substancës së normave të këtyre dy ligjeve, të cilat mbronin disa vlera kushtetuese më superiore, më sublime se vlerat tjera që normoheshin me ligjet e zakonshme. Një gjë e tillë parashikohej me nenet 8 ["Cenimi i të Drejtave"] të **Ligjit Bazik: Dinjiteti Njerëzor dhe Liria**[46] dhe nenit 4 ["Cenimi i Lirisë së Profesionit"] të **Ligjit Bazik: Liria e Profesionit.**[47] Këto dy ligje, thënë ndryshe, vunë klauzolën kufizuese në dispozitat e veta ashtu që **Knesseti** tani e tutje duhej të kishte shumë kujdes se çfarë ligjesh në substancë po nxirrte, në mënyrë që ligjet e reja mos të binin në kundërshtim me këto dy ligje bazike, ligje që u cilësuan si ligje me vlerë super legale, përkatësisht si ligje me vlerë superiore kushtetuese. Përveç klauzolës kufizuese, dhe kushteve që duheshin plotësuar për t'i kufizuar (cenuar) ligjërisht të drejtat e garantuara me këto ligje, standardi i vënë me nenin 4 të **Ligjit Bazik: Knesseti** ngeli në fuqi: këto ligje nuk mund të ndryshohen përveçse me një shumicë absolute të të gjithë anëtarëve të **Knessetit.**

Normat në fjalë, megjithatë, nuk qartësonin rolin dhe pozitën e gjyqësorit izraelit në aspektin e ushtrimit të kontrollit të kushtetutshmërisë: kush do ta bënte këtë kontroll, vetëm instanca më e lartë gjyqësore, **GJSIz**, apo kjo mund të bëhej nga çdo gjykatë e rregullt në vend? Kjo pyetje nuk ka marrë një përgjigje ligjore: nuk ka pasur një ligj apo një normativë tjetër e cila do të përcaktonte palët e autorizuara, juridiksionin, bazat për ngritjen e kërkesës për kontroll të kushtetutshmërisë, si dhe procedurat që duhen ndjekur në gjykatë lidhur me këtë. Kjo pyetje mori një përgjigje meritore pak vite më vonë, sërish përmes praktikës gjyqësore të **GJSIz**. E kemi fjalën këtu për rastin e sipër cekur **United Mizrachi Bank v. Migdal Cooperative Village**.

Në këtë rast, çështje kontestuese ka qenë e drejta e pronës, e cila, sipas palëve, që ishin një grup fshatarësh, qe cenuar nga një ligj i **Knesset**-it. Fshatarët fituan të gjitha shkallët gjyqësore në Izrael dhe rasti,

---

45 Për rastin **Bergman v Minister of Finace** dhe rastet tjera të pakta, si dhe për vetëpërmbajtjen e **GJSIz** në këtë periudhë, cf. më shumë në Ibid. fq. 109-117.

46 Neni 8 ["Cenimi i të Drejtave"]: "Nuk mund të cenohen të drejtat e përcaktuara me këtë ligj përveç rasteve kur një gjë e tillë bëhet me ligji dhe është në përputhje me vlerat e Shtetit të Izraelit, I shërben një qëllimi të përshtatshëm dhe nuk kalon masën më shumë se që është parashikuar me ligj apo me ndonjë urdhër shprehimor ligjor".

47 Neni 4 ["Cenimi i Lirisë së Profesionit"]: "Nuk do të ketë cenim të së drejtës së profesionit përveç kur përcaktohet me ligj në pajtim më vlerat e Shtetit të Izraelit, i cili nxirret për një qëllim përkatës, dhe në atë masë që është e domosdoshme apo përmes një rregulloreje që nxirret në bazë të një autorizim shprehimor ligjor".

për shkak të rëndësisë se vet kushtetuese, kaloi për vendosje sipas ankesës në **GJSIz**. Kjo afirmoi statusin kushtetues të dy ligjeve bazike si më sipër të vitit 1992 (të amendamentuar më 1994), të cilat garantonin pronën dhe lirinë e profesionit, në mesin e të drejtave tjera të cenuara nga **Knesset**-i. Kufizimi dhe, për pasojë, cenimi i këtyre të drejtave, sipas **GJSIz**, mund të ndodhte vetëm nëse plotësoheshin disa kushte: kufizimi (cenimi) duhej të bëhej me ligj, të ishte i arsyeshëm, proporcional dhe, në fund, të ishte në pajtim me vlerat e **Shtetit të Izraelit**. Duke afirmuar klauzolën e kufizimit nga dy ligjet bazike, në këtë rast **GJSIz** shkoj më tutje dhe tha se çdo ligj bazik i nxjerrë që nga themelimi i Izraelit nuk mund të binte ndesh me dispozitat kufizuese të këtyre dy ligjeve dhe vlerave kushtetuese superiore që këto ligje sanksionojnë. Me këtë qëndrim, **GJSIz** përfundimisht përcaktoi se **Izraeli** kishte një kushtetutë, përkatësisht një sistem të normave superiore kushtetuese të cilat autorizonin gjyqësorin që të mos zbatonte, njëjët si në **SHBA**, asnjë ligj apo normë tjetër juridike që binte ndesh me këtë sistem të normave kushtetuese që për pikë referimi kishin këto dy ligje bazike të vitit 1992 (të amendamentuar në vitin 1994). Ky sistem i normave superiore kushtetuese i këtyre dy ligjeve bazike tani e tutje do të përbënte **Kartën e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut të Shtetit të Izraelit** dhe pikën kryesore të referimit me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së çdo ligji të **Knesset**-it në të ardhmen.[48]

Vlenë të përmendet këtu me këtë rast se literatura akademike në **Izrael** ka shtjelluar në mënyrë konstante çështjen e kontrollit të kushtetutshmërisë, ngecjeve, problemeve dhe perspektivave të këtij instituti me rëndësi për zhvillimin e demokracisë kushtetuese liberale. Në këtë kontest, kjo literaturë ka dhënë kontribut të madh në plotësimin e zbrazëtive ekzistuese në sferën e gjyqësisë kushtetuese, si pasojë e mungesës së një ligji organik që do t'i rregullonte në mënyrë gjithëpërfshirëse jo vetëm çështjet e juridiksionit dhe palëve te autorizuara, por edhe çështjet tjera lidhur me organizimin dhe funksionimin e gjyqësorit izraelit në sferën e kontrollit kushtetues. Në këtë kontekst, në literaturën mbi gjyqësinë kushtetuese janë grumbulluar disa baza juridike të cilat shërbejnë si pikë referimi për të ndjekur me sukses procedurat e ushtrimit të kontrollit të kushtetutshmërisë dhe janë vënë disa standarde sa i përket modelit të kontrollit të kushtetutshmërisë që mund të ushtrohet në vend. Të gjitha këto qasje doktrinare bazohen në interpretimin e praktikës gjyqësore në **Izrael** dhe paraqesin një përmbledhje doktrinare të kësaj praktike. Kjo sepse, siç u tha, në **Izrael** akoma nuk ka një standard ligjor të përcaktuar me shkrim lidhur me **palët e autorizuara**, **juridiksionin**, **bazat për ngritjen e kërkesës për kontrolll të kushtetutshmërisë**, si dhe lidhur me **procedurat tjera që duhen ndjekur me atë rast.**

Bazuar në praktikën e stabilizuar mirë përmes precedentëve të **GJSIz**, palët e autorizuara për të nisur kontrollin gjyqësor të kushtetutshmërisë së një ligji ndryshojnë në vartësi të asaj nëse bëhet fjalë për **kontrollin e drejtpërdrejtë** apo për **kontrollin e tërthortë** të kushtetutshmërisë. Në **Izrael** nuk ekziston **kontrolli abstrakt** i kushtetutshmërisë së ligjeve dhe normave të tjera juridike, njëjët si në **SHBA** dhe vendet tjera që modelohen sipas sistemit amerikan.[49]

---

[48] Për tekstin e vendimit në rastin **United Mizrachi Bank v. Migdal Cooperative Village**, komentet akademike lidhur me pasojat dhe rëndësinë e tij kushtetuese, cf. në punimet si vijon: Yoram Rabin and Arnon Gutfel, "*Marbury v. Madison* And Its Impact On Israeli Constitutional Law". *University of Miami International and Comparative Law Review* Vol. 15 No. 2 (2007) fq. 303-335 në fq. 318-330; Oren Soffer, "Judicial Review of Legislation in Israel: Problems and Implications of Possible Reform. *Israel Affairs* Vol. 12 No. 2 (2006) fq. 307-329 (autori në këtë shkrim kritikon kontrollin gjyqësor të ushtruar nga ana e **GJSIz** bazuar në dy ligjet bazike të vitit 1992, sepse këto ligje janë parciale dhe me këtë ajo vetëm po krijon tensione dhe po bëhet pjesë e krizës politike; përveç saj autori thekson se mungesa e një kushtetute të shkruar në **Izrael** dhe fragmentimi dhe jo homogjeniteti brenda shoqërisë izraelite shërben më tutje si një shkak për mosushtrim aktiv të kontrollit gjyqësor sepse, një gjë e tillë, sipas autorit, po e rrënon autoritetin e **GJSIz**); Gideon Sapir, "Constitutional Revolutions: Israel as a Case-Study". *International Journal of Law in Context* Vol. 5 No. 4 (2009) fq. 355–378 në fq. 360; 362-365; Daphne Barak-Erez,"BROADENING THE SCOPE OF JUDICIAL REVIEW IN ISRAEL: BETWEEN ACTIVISM AND RESTRAINT". *Indian Journal of Constitutional Law* Vol. 8 No. 3 (2009) fq. 119-137 në fq. 121 (autori në përgjithësi në këtë shkrim kritikon kontrollin e kushtetutshmërisë dhe e quan "revolucion diskrecional", pra jo "revolucion kushtetues", sepse, sipas tij, **GJSIz** bën kontroll kushtetues vetëm në çështjet jopolitike dhe kujdeset për të mos nervozuar sovranin që gjendet në Knesset si dhe organet administrative që veprojnë në territoret e okupuara); Rivka Weill, "Hybrid Constitutionalism: The Israeli Case for Judicial Review and Why We Should Care". *Berkely Journal of International Law* Vol. 30 No. 2 (2012) fq. 349-411 në fq. 350; 381; 406-407.

[49] Suzie Navot, *The Constitutional Law of Israel,* fq. 162.

Në rastin e **kontrollit të drejtpërdrejtë**, si palë e autorizuar mund të paraqitet çdo person fizik apo juridik nga e drejta private apo publike, që pohon se me një ligj të caktuar ia kanë cenuar (kufizuar) të drejtat dhe liritë kushtetuese të garantuara me dy ligjet bazike të vitit 1992. Këto dy ligje janë pika e referimit për vlerësim të kontrollit të kushtetutshmërisë së secilit ligj të **Knesset**-it që është në fuqi. Këto ligje, siç u tha më sipër, përbëjnë **Kartën e të Drejtave të Njeriut në Izrael**. Për të qenë i suksesshëm, sipas praktikës së deritanishme gjyqësore, kërkuesi duhet të dëshmojë rrethanat si vijon:

- se, një ligj i miratuar dhe në fuqi cenon të drejtat dhe liritë konkrete të garantuara me dy ligjet bazike si më sipër;
- se, cenimi i këtyre të drejtave dhe lirive të garantuara si më sipër është bërë në kundërshtim me klauzolën kufizuese të parashikuar në dy ligjet në fjalë, përkatësisht se ai cenim nuk është me vend, nuk është proporcional dhe, në fund fare, nuk ka të bëjë me ruajtjen e vlerave të **Izraelit** si shtet hebre dhe demokratik i të gjithë qytetarëve dhe atyre që banojnë në të;
- se, këto cenime të drejtave dhe lirive të garantuara me këto ligje është bërë në kundërshtim me zakonin izraelit lidhur interpretimin që thotë se çdo ligj supozohet se është kushtetues dhe i vlefshëm derisa mos të vërtetohet e kundërta.

Në rastin e **kontrollit të tërthortë** të kushtetutshmërisë, si palë të autorizuara paraqiten gjyqtarët kompetent e gjyqësorit izraelit, apo gjykatat me kompetencë ligjore në sistemin gjyqësor izraelit, para të cilëve gjendet për t'u vendosur apo zgjidhur një çështje apo mosmarrëveshje konkrete. Në këto raste, vetë gjyqtari përkatësisht trupi gjykues ka të drejtë për të vendosur lidhur me kushtetutshmërinë e ligjit apo normës tjetër juridike e cila duhet të zbatohet në rastin apo mosmarrëveshjen konkrete. Në **Izrael**, megjithatë, sot në përgjithësi pranohet se autoriteti për anulim të ligjeve i takon vetëm **GJSIz**, e cila vepron në rolin e dytë, pra si **GJLDIz.**[50]

Sa i përket bazave për ushtrim të kërkesës për inicim të procedurave për kontroll të kushtetutshmërisë, tri janë bazat e mundshme në të cilat palët mund të mbështesin kërkesën e tyre për shpalljen e ligjit si kundërkushtetues: bazat që kanë të bëjnë me cenimet procedurale gjatë nxjerrjes së ligjit; bazat që lidhen me cenimin e rëndë të të drejtave të mbrojtura njerëzore dhe, së fundi, me bazat që kanë të bëjnë me cenimin e parimeve të sistemit izraelit.[51]

Bazat që lidhen me të metat procedurale të ligjeve janë thuajse të njëjta me sistemet tjera juridiko – kushtetuese, përfshirë këtu **Kosovën**: këto situata lindin atëherë kur ligji është nxjerrë pa respektuar procedurat për nxjerrjen e tij, procedura që zakonisht përcaktohen me ligj dhe me rregullat e brendshme të parlamentit. Një rast si ky, pra kur kushtetutshmëria e ligjit është sfiduar mbi bazën e të metave procedurale, ka ndodhur në vitin 2004 dhe njihet si rasti **Israel Poultry Farmers Association v. Government of Israel.**[52] Megjithatë, **GJSIz**, duke vendosur si **GJLDIz**, vendosi se ligji i sfiduar nuk kishte të meta fundamentale procedurale që do të shërbenin si bazë për anulimin e tij. Raste tjera deri më sot nuk ka pasur.

Kërkesat për anulim të ligjeve mbi bazën e jo kushtetutshmërisë së tyre në sferën e të drejtave të njeriut janë më të shumtat në numër. Sfidimi këtu koncentrohet në atë se një ligj i zakonshëm cenon në mënyrë të rënd të drejtat themelore njerëzore të garantuara me ligjet bazike të **Izraelit**. Mbrojtja e të drejtave të njeriut paraqet cilësinë më karakteristike të së drejtës kushtetuese të Izraelit. Meritat për këtë i ka **GJSIz**, e cila, duke vepruar si **GJLDIz**, ka ndërmarrë hapa të guximshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive njerëzore duke krijuar atë që njihet në Izrael si **Karta e të Drejtave të Gjyqësorit** (që ka kuptimin

---

50 Suzie Navot, "Israeli Supreme Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre and Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* (Cambridge University Press: Cam bridge, 2017) fq. 471- 515 në. fq. 476.

51 *Suzie Navot, The Constitutional Law of Israel,* fq. 162-165.

52 HCJ 4885/03 **Israel Poultry Farmers Association v. Government of Israel.** *Israel Law Reports* [2004] Israel Law Reports 383. Në internet: http://versa.cardozo.yu.edu/sites/default/ files/ upload/opinions/Israel%20 Poultry%20Farmers%20Association%20 Agricultural%20Cooperative%20Society%20Ltd.%20v.%20State%20of%20Israel.pdf (shikuar në shtator 2017).

e të drejtave të krijuara si rezultat i aktivitetit permanent të gjyqësorit izraelit, përkatësisht të drejtave të krijuara si rezultat i aktivizimit të madh dhe kreativ të **GJSIz**). Këto të drejta sot përbëjnë të drejtat zakonore figurojnë lartë në gjykimet e gjyqësorit izraelit në të gjitha nivelet. Ky standard është vënë që nga vitit 1995.[53]

Së fundi, baza për anulim të ligjeve që ka të bëjë me cenimin e parimeve të sistemit paraqet bazën më interesante. Si e tillë, asnjëherë nuk është zbatuar në praktike dhe për momentin përbën vetëm një mundësi teorike.[54] Esenca e kësaj baze për sfidim të kushtetutshmërisë së ligjeve qëndron në atë atë se si t'u jepet fuqi normative superiore (kushtetuese) disa parimeve abstrakte të së **drejtës natyrore**. Kjo dilemë për herë të parë përmendet në vitin 1965 në rastin e njohur si **El Arad**. Në këtë rast çështja ka qenë si të vendoset mbi bazën e parimeve jo të shkruara, të nxjerra nga fusha e të drejtës natyrore, e që kishin të bënin me aktivitetin e një partie politike që, në kuadër të platformës së vet politike, e kishte mohimin e ekzistimit të **Shtetit të Izraelit**. Me vonë, kjo çështje është ngritur edhe në disa raste tjera në praktikë. **GJSIz**, megjithatë, me shumë sukses ka shmangur anulimin e ligjeve me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) kushtetuese, duke u bazuar në parime jo të shkruara abstrakte me rrënjë nga e drejta natyrore.[55]

Procedurat për sfidim të kushtetutshmërisë së ligjeve nuk ankorohen në një ligj të veçantë organik me të cilin do të njihej e drejta për kontroll kushtetues, siç është rasti me shumicën e shteteve tjera. E drejta për kontrolli kushtetues të ligjeve dhe të veprimit administrativ të shtetit izraelit ka lindur, siç u pa më herët, nga praktika gjyqësore dhe atë në një mënyrë graduale. Fakti që nuk ka ligj të tillë organik ka bërë që **GJSIz** të jetë më e përmbajtur në anulimin e ligjeve. Më sipër u diskutuan procedurat në dy llojet e kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve: sfidimi i drejtpërdrejt i kushtetutshmërisë së ligjeve dhe sfidimi përmes rrugës së tërthortë apo incidentale.

Përveç këtyre dy procedurave, në **GJSIz** mund të paraqiten edhe **ankesat kushtetuese** kundër veprimit administrativ të shtetit: çdoherë kur qytetari ndihet i rrezikuar apo i kufizuar në gëzimin e drejtave dhe lirive të veta të garantuara si pasojë e veprimit administrativ të shtetit, ka të drejtë që t'i drejtohet asaj në mënyrë të drejtpërdrejtë. Kjo është unike dhe vështirë se gjendet në ndonjë vend tjetër në botë. Në këto procedura, **GJSIz** bën kontrollin gjyqësor të kushtetutshmërisë së veprimit administrativ shtetëror, duke vepruar si **GJLDIz** në shkallë të parë, të fundit dhe të vetme. Kjo procedurë bazën e vet e ka në **Ligjin Bazik: Gjyqësori** (1984), i cili, në nenin 15 nën "c" ["Gjykata Supreme"] thekson se kur "[…] Gjykata Supreme vepron si **GJLDIz**, ajo mund t'i shqyrtojë edhe ato raste për cilat konsiderohet se është e domosdoshme që të ofrohet mbrojtja për hir të drejtësisë."[56] Për të ndodhur kjo, në po këtë dispozitë parashikohet plotësimi i një kushti: që çështja të mos jetë nën juridiksionin e asnjë gjykate tjetër në **Izrael.** Nëse ky është rasti, këtë e vendos vet **GJSIz.**

Procedurat për kontrollin kushtetues të veprimit administrativ të shtetit janë shumë të shpejta dhe lehtë të qasshme për individët e prekur (lënduar) nga veprimi i tillë administrativ. Nuk ka dëshmi me gojë dhe nuk ka marrje në pyetje të dëshmitarëve, pra në tërësi procedura bazohet në vlerësimin nëse veprimi administrativ i shtetit cenon të drejtat e individit bazuar në atë që shihet nga prezantimi i vetë palëve. Kjo sepse procedura ka për qëllim ofrimin e mbrojtjes së menjëhershme, aty për aty, për "hir të drejtësisë" dhe me qëllim të mbrojtjes së individit kundër arbitraritetit të veprimit administrativ shtetëror. Në këtë drejtim, **GJSIz** asnjëherë nuk ka refuzuar të trajtojë ankesat e qytetarëve të bëra kundër veprimit administrativ të shtetit. Kur ajo ofron mbrojtje të tillë, atëherë nxjerr urdhra gjyqësor që kanë për qëllim restaurimin e menjëhershëm të të drejtave të cenuara me veprim administrativ shtetëror. Të kësaj natyre janë urdhrat **habeas corpus** dhe **mandamus**, të cilat **GJSIz** mund t'i lëshojë kundër çdo vendimi apo veprimi administrativ të organeve shtetërore apo të organeve të tjera, të veshura me autorizime publike

---

53 Suzie Navot, "Israeli Supreme Court", fq. 482.

54 Suzie Navot, *The Constitutional Law of Israel,* fq. 164.

55 Ibid. 164 dhe 233.

56 *BASIC LAW: THE JUDICIARY* (5748 - 1984). Në internet: http://knesset.gov.il/laws/ special/eng/BasicLaw TheJudiciary.pdf (shikuar në gusht 2017).

nga lëmi administrativ.[57] Në situatën në të cilën gjendet **Izraeli** që nga themelimi i tij si shtet, veprimi administrativ i shkaktuar nga arsyet e sigurisë është veprim rutinor ashtu që kontrolli gjyqësor i tij ka një rëndësi të madhe për ruajtjen e demokracisë kushtetuese në këtë vend. Lufta kundër terrorizmit duhet të zhvillohet, siç e ka thënë **Aron Barak** (Aharon Barak, juristi izraelit me famë botërore dhe kryetari dhe gjyqtari i **GJSIz** për një kohë të gjatë), "me një dorë të lidhur prapa shpine". Metafora e dorës prapa shpine ka të bëj me kalorësit fisnik dhe trima të kohës së Mesjetës, që kanë luftuar duke respektuar rreptësisht rregullat e paracaktuara të dyluftimit. Kjo luftë kundër terrorizmit në këtë vend, me fjalë të tjera, duhet të bëhet brenda ligjit dhe assesi në mënyrë arbitrare.[58]

8.3. Vendet e Azisë Qendrore (Azerbajxhani, Kazakistani, Kirgistani, Taxhikistani, Uzbekistani)

Këto vende, njëjtë si **Mongolia**, ka pasur mundësi që të diskutohen në kuadër të ish-vendeve komuniste. Kjo për shkak të faktit se me këto vende kanë një ngjashmëri të madhe si në lëmin e gjyqësisë kushtetuese, ashtu edhe sa i përket dizajnit kushtetues dhe institucional shtetëror. Po ashtu, këto vende mund të diskutohen edhe në kuadër të vendeve islamike, nisur nga fakti se kulturalisht posedojnë një stof të fortë islamik, si dhe traditë të gjatë tribale të organizimit shtetëror. Ne kemi vendosur që, megjithatë, këto vende t'i trajtojmë në këtë kapitull për arsyet e cekura në fillim të këtij kapitulli, që janë arsye të natyrës metodologjike, si dhe për shkak të lehtësisë së trajtimit të tyre në këtë kuadër gjeografik dhe ngjashmërisë së tyre institucionale me vendet perëndimore më shumë se me ato islamike.

Këtë e kemi bërë gjithnjë me shpresë së këto vende, si të tilla, mund të shërbejnë si një pikë referimi për të kuptuar gjyqësinë kushtetuese laike në vendet ish-sovjetike: ani se kanë një stof kulturor islamik, ndikimet e sistemit **evropian/kelsenian**, përmes **Komisionit te Venecias**, kanë bërë që të trajtohen si pjesë e origjinës dhe zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese perëndimore. Kjo vlen për të gjitha vendet e këtij rajoni gjeografik, pra edhe për ato që nuk kanë gjykata të veçanta kushtetuese, por që këtë funksion, pra funksionin e ruajtjes së supremacisë (epërsisë) së kushtetutës, e ushtron një organ tjetër ekuivalent (gjykatë supreme apo këshill kushtetues). Rrethana që këto vende asnjëherë nuk kanë pasur ndonjë traditë të ndarjes së pushtetit dhe të demokracisë kushtetuese në përgjithësi, orientimi i tyre i theksuar evropian dhe perëndimor, por në të njëjtën kohë edhe ndikimi rus në to,[59] së bashku bëjnë që ato të jenë më specifike dhe ta detyrojnë studiuesin për një trajtim të tyre sipas kriterit konceptual, institucional dhe gjeografik në të njëjtën kohë. Kjo bëhet edhe më e qartë kur të kihet parasysh **zgjidhja institucionale** në lëmin e gjyqësisë kushtetuese të cilën e kanë përqafuar këto vende. Të shohim si duket kjo në secilin nga këto vende.

Organet e kontrollit të kushtetutshmërisë në **Azinë Qendrore** përfaqësojnë një tërësi variacionesh të sistemeve të gjyqësisë kushtetuese: **Turkmenistani** nuk ka fare gjykatë kushtetuese, në një kohë që ekzistojnë gjykatat kushtetuese të ndara të llojit klasik dhe tradicional në **Taxhekistan (GJKTa)** dhe **Uzbekistan (GJKUz)**. **Kazakistani** ka një këshill kushtetues (**KKKaz**) e **Kirgistani** vetëm një

---

57 Suzie Navot, "Israeli Supreme Court", fq. 475.

58 Aharon Barak, "The Supreme Court and the Problem of Terrorizm". Në Supreme Court of Israel and Ministry of Foreign Affairs (eds.), *Judgements of the Israel Supreme Court: Fighting Terrorism within the Law*. Vol. 1 (Jeruslaem, 2009) fq. 9-22 në fq. 9. Kjo përmbledhje e aktgjykimeve kryesore të **GJSIz** lidhur me kontrollin gjyqësor të kushtetutshmërisë së veprimit administrativ të **Shtetit të Izraelit** ka tri vëllime. Këto vëllime, autori parë i këtij libri i ka pranuar si dhuratë me dedikim të veçantë nga ish kryetarja e **GJSIz**, znj. **Dorit Beinish** (Dorit Beinisch), me rastin e vizitës së tij në **Izrael** prej datës 1 deri më 3 shkurt 2012, në cilësinë e kryetarit të **Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës**.

59 Grigory Dikov, *Judicial Systems of Central Asia. A Comparative Overview* (Jurisprudence: Moscow, 2015) fq. 7-32 në fq. 9, 13; Furkat Zhurakulov, "Separation of Powers in the States of Central Asia and the Caucasus". *Central Asia and the Caucasus* Vol. 12 No. 4 (2011), fq. 46–57. Në internet: http://cyberleninka.ru/article/n/ separation-of-powers-in-the-states-of-central-asia-and-the-caucasus (shikuar në korrik 2017); Për origjinën sovjetike të sistemit legal në vendet e **Azisë Qendrore**, cf. më shumë në Muhammad Zubair and Sadia Khattak, "A comparative analysis of legal system in central Asia: from pre-tsarist period to soviet Russia" *WALIA journal* 31(S6) (2015), fq. 1-5 2015. Në internet: www.Waliaj.com (shikuar në korrik 2017); dhe Gerald Staberock, "A Rule of Law Agenda for Central Asia" *Essex Human Rights Review* Vol. 2 No. 1 (2005), fq. 1-22.

dhomë speciale kushtetuese në kuadër të Gjykatës Supreme (**DHKGJSKir**). Këto vende nuk i trajtojmë sipas organeve të kontrollit kushtetues që kanë, por sipas rendit alfabetik.

Azerbajxhanin e trajtojmë në fillim këtu para se të kalojmë me vendet e **Azisë Qendrore** jo vetëm për shkak të alfabetit, por për shkak të tri fakteve të tjera: e para, për shkak se, si një ish-republikë sovjetike, ky vend shtrihet në atë pjesë të **Kaukazit Jugor** të **Euro-Azisë** që lidhë **Azinë Perëndimore** me **Evropën Lindore**; e dyta, për shkak të faktit se bën pjesë në kuadër të **vendeve turkike**, krahas vendeve të tjera turkike të **Azisë Qendrore** (me përjashtim të **Taxhekistanit,** i cili është një vend më shumicë etnike persiane), të cilat i diskutojmë këtu më poshtë; dhe, së fundi, e treta dhe më e rëndësishmja, për shkak të faktit se ka një gjykatë të ndarë kushtetuese me kompetenca mjaft të gjëra dhe mbresëlënëse për atë pjesë të botës. Fakti se ka qenë **ish-republikë sovjetike** çon mjaft shumë peshë sepse, njëjtë si në rastin e **Mongolisë**, sistemi dhe kultura juridike sovjetike akoma luan rol dhe vjen në shprehje në jetën juridiko-kushtetuese dhe politike të këtij vendi.

Nga të gjitha vendet turkike, me përjashtim të **Turqisë**, të cilën së bashku me **Izraelin** i kemi trajtuar në kuadër të sistemeve juridiko-kushtetuese me traditë të gjatë perëndimore, **Azerbajxhani** ka një gjykatë kushtetuese me një juridiksion jashtëzakonisht të gjerë që ngjason shumë me juridiksion të cilin e gëzon **Gjykata Kushtetuese e Kosovës**. Megjithatë, **Gjykata Kushtetuese e Azerbajxhanit** (GJKAz) , ka kompetenca më të gjëra, në veçanti kur flitet për **ankesën kushtetuese**, e cila është sanksionuar me ndryshimet kushtetuese në nenin 130 ["Gjykata Kushtetuese e Azerbajxhanit"] të Kushtetutës së vitit 1995, aktualisht në fuqi me amendamentet e fundit të vitit 2009.[60] Ndryshimet që futën **ankesën kushtetuese,** janë kryer me referendumin e datës 24 gusht 2002, me të cilin u aprovuan ndryshimet kushtetuese në fjalë, kurse vet gjykata kushtetuese ka nisur punën në vitin 1998.

Futja e ankesës kushtetuese, si dhe zgjerimi i rrethit të palëve të autorizuara për ta vënë në lëvizje **GJKAz** ka qenë pjesë e zotimeve që ky vend i ka marrë me rastin e anëtarësimit në **Këshillin e Evropës** në vitin 2000. **Ligji mbi Gjykatën Kushtetuese të Azerbajxhanit** i datës 23 dhjetor 2003, në fuqi nga vitit 2004, përmban dispozita të mëtejme që normojnë deri në detaje të gjitha procedurat e veçanta që mund të zhvillohen pranë Gjykatës.[61] Për dallim nga disa ligje tjera mbi gjykatat kushtetuese të vendeve të **Azisë Qendrore,** ky ligj nuk përcakton kompetenca shtesë jashtë atyre të përcaktuara me nenin 130: me pikën VIII të nenit 130 të Kushtetutës, vetëm teksti kushtetues paraqet burim të juridiksionit të kësaj gjykate. Një qasje e tillë konfirmohet me nenin 1 ["Objektivat dhe Detyrat Themelore të Gjykatës Kushtetuese"] të Ligjit, i cili thekson se Gjykata "[...] është organi suprem i drejtësisë kushtetuese në çështjet e përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Azerbajxhanit", kurse objektivat themelore të saj [...] do të jenë sigurimi i supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të secilit". Vlen të theksohet me këtë rast se Ligji ka pasur një vlerësim të lartë nga ana e **Komisionit të Venecias**, në veçanti kur bëhet fjalë për zgjerimin e rrethit të palëve të autorizuara.[62]

Në nenin 7. 3 ["Shteti i Azerbajxhanit"] të Kushtetutës numërohen tri pushtetet klasike, të cilat cilësohen si të ndara dhe të balansuara njëri me tjetrin. Në këto tri pushtete nuk hyn **GJKAz**. Kjo do të thotë se në **Azerbajxhan**, ajo nuk konsiderohet si pjesë e tri pushteteve por si **pouvoirs constitués**, pushtet i krijuar sipas kushtetutës me juridiksion dhe kompetenca të prera, të ndara dhe të qarta kundrejt secilit organ tjetër shtetëror dhe publik, që për punën e vet i përgjigjet vetëm kushtetutës dhe ligjeve nacio-

---

60 Constitution of Azerbaijan of 1995 with Amendments through 2009. Në internet: https://www.constituteproject. org/constitution/Azerbaijan_2009.pdf?lang=en (shikuar në korrik 2017).

61 *THE LAW OF AZERBAIJAN REPUBLIC ON CONSTITUTIONAL COURT of 23 December 2003*. Në internet: http://www.ilo.org/dyn/natlex/natlex4.detail?p_lang=&p_isn=71141&p_classification=01.01 (shikuar në korrik 2017)

62 Cf. EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION), *DRAFT OPINION DRAFT LAW ON THE CONSTITUTIONAL COURT OF THE REPUBLIC OF AZERBAÏJAN.* OPINION N°172 / 2002, CDL (2002) 25 (Strasbourg, 5 March 2002). Seksionet 2.1 ["Qasja Individuale"], 2.2 ["Qasja nga Gjykatat e të gjitha niveleve"], dhe 2.3 ["Qasja për organet tjera publike"] të Opinionit.

nale. Se kjo është kështu shihet edhe nga një rrethanë tjetër e sanksionuar me Kushtetutë: deri sa shefi i Shtetit azerbajxhanas, sipas nenit 8 ["Kreu i Shtetit të Azerbajxhanit"] të Kushtetutës, ngarkohet me sigurimin e pavarësisë së gjyqësorit vendor, një gjë e tillë askund në Kushtetutë nuk figuron sa i përket sigurimit të pavarësisë së gjyqësisë kushtetuese. Këtë e bën vetëm një institucion, **GJKAz**, e shtetit me rregullim presidencial republikan, laik, unitar dhe i bazuar në sundim të ligjit.[63] Këtë pavarësi të gjyqësisë kushtetuese e garanton Kushtetuta, si në aspektin institucional, financiar dhe të personelit, por, mbi të gjitha, kjo pavarësi sigurohet në aspektin juridiksional përmes normimit të tij me nenin 130 të Kushtetutës.

Asgjë nuk ndryshon në këtë aspekt fakti që në nenin 125.2 ["Pushteti Gjyqësor"] të Kushtetutës, si pjesë e pushtetit gjyqësor përmendet edhe **GJKAz.** Dispozitë identike kanë edhe kushtetutat e **Taxhikistanit** dhe **Uzbekistanit**, të cilat diskutohen në vijim. Shënojmë me këtë rast se, pavarësia juridiksionale, institucionale, financiare dhe e personelit janë anët kryesore, të cilat përcaktojnë vendin dhe rolin e një gjykate kushtetuese në sistemin juridik – kushtetues të një vendi, jo vendi i saj formal në kuadër të dispozitave të kushtetutës.[64]

Pavarësia juridiksionale e **GJKAz** normohet vetëm me një nen, me nenin 130 të Kushtetutës. Paragrafi i parë i këtij neni thekson se ajo përbëhet prej nëntë gjyqtarëve, kurse i dyti sqaron se zgjedhjen e tyre e bën parlamenti i vendit me propozim të shefit të Shtetit.

Me kërkesë të shefit të Shtetit, të qeverisë, parlamentit, të prokurorit të përgjithshëm, të gjykatës supreme dhe, në fund, të parlamentit provincial të **Republikës Autonome të Nakhchivan**-it, sipas paragrafit të tretë, **GJKAz** vendos lidhur me këto çështje:

1. kushtetutshmërinë e ligjeve, dekreteve dhe urdhrave të Presidentit, vendimeve të Parlamentit, vendimeve dhe urdhrave të Qeverisë, të akteve normative të autoriteteve qendrore të pushtetit ekzekutiv;
2. pajtueshmërinë e dekreteve të Presidentit, vendimeve të Qeverisë, akteve normative të autoriteteve qendrore ekzekutive me ligjet e Republikës;
3. pajtueshmërinë vendimeve të Qeverisë, akteve normative të autoriteteve qendrore ekzekutive me dekretet e Presidentit të Republikës;
4. pajtueshmërinë e vendimeve të **Gjykatës Supreme të Azerbajxhanit** me Kushtetutën dhe ligjet republikane, në rastet e përcaktuara me ligj;
5. pajtueshmërinë e akteve komunale me Kushtetutën, ligjet republikane, dekretet e Presidentit, vendimet e Qeverisë (në **Republikën Autonome të Nakhchivan**-it, aktet komunale duhet të jenë në pajtim edhe me Kushtetutën, ligjet dhe vendimet e Qeverisë së **Republikës Autonome të Nakhchivan**-it);
6. pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërshtetërore të **Republikës së Azerbajxhanit**, të cilat akoma nuk janë në fuqi, me Kushtetutën e Republikës, si dhe pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërqeveritare të Azerbajxhanit me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës;
7. pajtueshmërinë e Kushtetutës së Republikës Autonome të Nakhchivan-it, të ligjeve, vendimeve të parlamentit dhe të qeverisë provinciale me **Kushtetutën e Republikës së Azerbajxhanit**;
8. pajtueshmërinë e ligjeve dhe vendimeve të qeverisë të **Republikës Autonome të Nakhchivan**-it me ligjet e **Republikës së Azerbajxhanit**;
9. pajtueshmërinë e vendimeve të qeverisë së **Republikës Autonome të Nakhchivan**-it me dekretet e Presidentit të Republikës së Azerbajxhanit dhe me vendimet e qeverisë qendrore në Azerbajxhan;

63 Neni 7.1 ["Shteti i Azerbajxhanit"] të Kushtetutës.

64 Për pavarësinë institucionale, financiare dhe në personel të **GJKAz**, shih dispoiztat implementuese të nenit 130 të Kushtetutës, të cilat gjenden në kapitujt I ["Dispozitat e Përgjithshme"], II ["Bazat për Oragnizimin dhe Aktivitetin e Gjykatës Kushtetuese"] dhe IX ["Organizimi dhe Mirëvajtja e Gjykatës Kushtetuese"] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

10. zgjidhjen e konflikteve lidhur me ndarjen e pushteteve në mes të legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit.

Në paragrafin e katërt, me kërkesën e subjekteve të njëjta të autorizuara si në paragrafin paraprak, ajo bën interpretimin e Kushtetutës dhe të ligjeve azere. Si palë të autorizuara për të ngritur çështjet nga pika 1 dhe 7 e paragrafit të tretë si më sipër paraqiten edhe individët në rastet kur aktet juridike dhe normative të autoriteteve legjislative, ekzekutive dhe të komunave, si dhe vendimet e gjykatave cenojnë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Kjo përcaktohet me paragrafin e pestë dhe, sipas stipulimit të fjalisë së fundit të kësaj dispozitë, ka për qëllim restaurimin e të drejtave dhe lirive të cenuara me aktet i më sipër.

Në të gjashtin paragraf normohet autorizimi i Gjykatës Kushtetuese për të ushtruar interpretim të Kushtetutës. Kjo mund të bëhet sipas kërkesës së secilës gjykatë në vend, por me kusht që bëhet fjalë për interpretim të Kushtetutës dhe ligjeve që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e të drejtave dhe lirive njerëzore. Jo vetëm kaq! Në lëmin e lirive dhe të drejtave të njeriut, për mbrojtjen dhe promovimin e tyre, sipas paragrafit të shtatë, si palë e autorizuar paraqitet edhe Komisioneri për të Drejtat e Njeriut dhe për objekt kontrolli kushtetues mund të jenë aktet juridike dhe normative të autoriteteve ekzekutive dhe të komunave si dhe vendimet e gjykatave që cenojnë të drejtat dhe liritë njerëzore.

Paragrafët e fundit, respektivisht i teti, i nënti dhe i dhjeti flasin për kompetencat tjera që mund të ushtrohen nga **GJKAz**, por vetëm nëse janë të përcaktuara me Kushtetutë,[65] jo me ligje, pastaj flasin për efektin detyrues të vendimeve, publikimin dhe efektin e tyre juridik.

Para se ta mbyllim diskutimin për **Azerbajxhanin**, t'i rikthehemi sërish çështjes së **ankesës kushtetuese**, sepse vërtetë përbën një risi kushtetuese në këtë pjesë të botës, si në formë ashtu dhe në përmbajtjen e saj.

Për nga forma, ajo është **ankesë jo e plotë kushtetuese**, nisur nga fakti se me të mund të goditet vetëm ana juridike e shkeljes kushtetuese, jo edhe aspektet faktike të shkeljes, të cilat aspekte ngelin në kompetencë të gjykatave të rregullta. Kjo nënkupton se, sipas stipulimit kushtetues të paragrafit të pestë të nenit të sipërcekur 130 të Kushtetutës, **ankesa kushtetuese** mund të ngrihet kundër akteve juridike, të përgjithshme dhe individuale, të autoriteteve shtetërore dhe publike por vetëm nëse shkelja e supozuar ka ndodhur si pasojë e jokushtetutshmërisë së aktit juridik të përgjithshëm që ka shërbyer si bazë juridike për vendimmarrje apo kur vet aktet juridike dhe normative të autoriteteve legjislative, ekzekutive dhe të komunave cenojnë të drejtat dhe liritë individuale konkrete. Përveç kësaj, si bazë për ushtrim të ankesës është edhe moszbatimi i aktit juridik nga ana e gjykatës, si dhe zbatimi i aktit juridik në mënyrë jokushtetuese.[66]

Sipas Ligjit, si palë të autorizuara përveç individëve mund të jenë edhe personat juridik, si dhe të huajt e personat pa shtetësi. Për t'u ushtruar aneks **kushtetuese** duhet të shteren mjetet juridike në nivel nacional. Ka dy përjashtime nga kjo nga kjo rregull: e para, nëse është cenuar e drejta për gjykim; dhe, e dyta, nëse mund të ndodhë një dëm i pariparueshëm ndaj individit, të drejtave dhe lirive të tij. Vetëm në këto dy raste pala që pohon se iu janë cenuar liritë dhe të drejtat kushtetuese mund të ushtrojë aneks kushtetuese në mënyrë të drejpërdrejtë dhe pa i shterrur mjetet juridike nacionale.[67]

Në **Kazakistan**, sikundër u tha, nuk ekziston një gjykatë të ndarë kushtetuese të tipit klasik, tradicional. Në këtë vend është formuar një këshill kushtetues, **KKKz.** Para pavarësimit të tij nga ish-**Bashkimi Sovjetik**, njëjtë si në Uzbekistan dhe në vendet tjera ish-sovjetike, ka ekzistuar një komitet për mbikëqyrjen e kushtetutshmërisë. Me fitimin e pavarësisë më 16 dhjetor 1991, ky vend nxori një ligj kushtetues që parashikonte themelimin e një organi të veçantë të kontrollit kushtetues, i cili u krijua më 1992. **Kushte-**

[65] Një kompetencë e tillë, ta zëmë, përcaktohet me nenin 107 ["Shkarkimi nga Detyra i Presidentit të Republikës"] të Kushtetutës.

[66] Cf. neni 34.2 ["Ankesa"] i Ligjit.

[67] Cf. neni 34.7 ["Ankesa"] i Ligjit.

tuta e Kazakstanit e vitit 1995, aktualisht në fuqi me disa amendamentime, parashikoi për herë të parë themelimin e **KKKz**, si një organ gjysmë – gjyqësor i kontrollit kushtetues. Ky organ shtetëror merret me sigurimin e supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës në tërë territorin e shtetit.[68]

Në kuadër të kompetencave të **KKKz**, një vend të rëndësishëm zë kontrolli kushtetues i kapacitetit shtetëror në sferën e lidhjes dhe përfundimit të traktateve ndërkombëtare. Kjo kompetencë, sot e përhapur mjaft ndër gjykatat kushtetuese të vendeve të ndryshme evropiane, ka qenë një makth për **Hans Kelsen** (Hans Kelsen: 1881-1973): sipas tij, siç do ta diskutojmë në pjesën që ka të bëjë me juridiksionin e **Gjykatës Kushtetuese të Kosovës**, kompetenca e gjyqësisë kushtetuese në sferën e kontrollit kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtarë duhet evituar. Kjo për shkak se një kompetencë e tillë do të kontribuonte në ngadalësimin dhe pengimin serioz të komunikimit ndërkombëtar ndërmjet shteteve dhe subjekteve të tjera të së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Kjo, megjithatë, nuk ka qenë pengesë për parashikimin e këtij lloj të kompetencës, por kryesisht në sferën e kontrollit preventiv të traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare. Këtu nuk bën përjashtim as **Kazakistani**: asnjë ligj apo traktat ndërkombëtar i cilësuar si jo kushtetues nga **KKKz** nuk mund të nënshkruhet përkatësisht ratifikohet me qëllim të futjes së tij në sistemin e brendshëm juridik.[69]

Përveç kompetencës si më sipër, **KKKz** është i autorizuar që të shfuqizojë ligjet dhe akteve tjera normative që cenojnë liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të qytetarit.[70] Ky shfuqizim mund të iniciohet vetëm me kërkesën e gjykatave të rregullta, të cilat, sipas nenit 78 ["Gjykatat dhe Drejtësia"] të Kushtetutës, shprehimisht e kanë të ndaluar të bëjnë zbatimin e ligjeve dhe akteve të tjera normative që cenojnë të drejtat dhe liritë kushtetuese. Nëse gjykatat gjatë gjykimit apo zgjidhjes së një rasti apo mosmarrëveshje gjejnë se ky është rasti, atëherë duhet të ndalojnë procedurat e tilla dhe çështjen ta referojnë në **KKKz**. Kjo do të thotë se në këtë vend ka një kontroll kushtetues të koncentruar (centralizuar), ku kushtetutshmëria vlerësohet vetëm nga **KKKz** dhe jo nga gjykatat tjera.

Përveç kompetencave si më sipër, **KKKz** ka edhe kompetenca lidhur me largimin e presidentit nga detyra,[71] kontrollin e kushtetutshmërisë së zgjedhjeve për president, për parlament, si dhe kompetenca në çështjet e realizimit të referendumit,[72] shqyrtimit të vendimeve të dy dhomave të parlamentit[73] dhe, në fund, kompetenca lidhur me interpretim zyrtar të standardeve të Kushtetutës.[74]

Para fitimit të pavarësisë, njëjtë si në ish-republikat tjera sovjetike të **Azisë Qendrore**, në **Kirgistan** ka ekzistuar modeli i komitetit të mbikëqyrjes kushtetuese. Ai ka qenë një organ politik, i motivuar ideologjikisht, që ka pasur në kompetencë të tij ruajtjen dhe sigurimin e kushtetutshmërisë socialiste të tipit sovjetik.

Ky organ politik i kontrollit të kushtetutshmërisë, i cili ka funksionuar në kuadër të **sovjetit suprem** të kësaj republike, njëjtë siç ka qenë rasti me të gjitha ish-republikat tjera sovjet-ike, ka funksionuar deri më 14 dhjetor 1990. Në këtë ditë janë bërë ndryshimet kushtetuese në **Kirgistan** dhe është krijuar një organ me juridiksion të posaçëm kushtetues, i veçantë dhe i ndara nga organet tjera gjyqësore, me autorizim të qartë për të mbrojtur dhe siguruar kushtetutshmërisë në vend. Në këtë aspekt, **Kirgistani** paraqet vendin e parë në ish- **Bashkimin Sovjetik** që ka krijuar gjyqësinë e parë kushtetuese, të llojit të ndarë dhe me kompetenca të qarta kushtetuese në lëmin e mbrojtjes dhe sigurimit të kushtetutshmërisë. E tërë kjo është bërë para shpalljes së pavarësisë më 31 gusht 1991.

---

68 Neni 1.1 ["Dispozitat e Përgjithshme: Statusi i Këshillit Kushtetues"] i Ligjit Kushtetues për Këshillin Kushtetues të Republikës së Kazakstanit i datës 29 dhjetor 1995, Ligji Nr. 2737.

69 Neni 72.1 pikat 2 dhe 3 ["Këshilli Kushtetutes"] i Kushtetutës.

70 Neni 72.5 ["Këshilli i Kushtetutës"] i Kushtetutës.

71 Neni 47 ["Presidenti"] i Kushtetutës.

72 Neni 72.1.1["Këshilli Kushtetutës"] i Kushtetutës.

73 Neni 72.1.2.1 ["Këshilli Kushtetues"] i Kushtetutës.

74 Neni 72.4 ["Këshilli Kushtetutës"] i Kushtetutës.

Vetëm kushtetuta e parë e **Kirgistanit** të pavarur dhe sovran (1993), megjithatë, në mënyrë kuptimplote dhe të guximshme ka parashikuar themelimin e **Gjykatës Kushtetuese të Kirgistant** (GJKKir). Në nenin 81.1 ["Gjykatata dhe Drejtësia"], Kushtetuta e definonte atë si organin më të lartë gjyqësor me autorizim për të mbrojtur **Kushtetutën e Republikës së Kirgistanit**. Edhe kjo Kushtetutë, njëjtë si në disa raste të tjera, trajtonte **GJKKir** në kuadër të sistemit gjyqësor nacional. Mirëpo, kjo nuk do të thotë asgjë për shkak se juridiksioni kushtetues dhe zgjidhja institucionale në këto vende, qartë tregojnë se fjala është për sistem të koncentruar (centralizuar) të gjyqësisë kushtetuese me gjykatën apo organin tjetër ekuivalent me monopol ekskluziv për të kryer interpretimin e kushtetutës me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së saj kundrejt çdo dokumenti tjetër juridik.

Para se t'i kthehemi zgjidhjes institucionale në **Kirgistan** pas nxjerrjes së kushtetutës aktuale të vitit 2010, e cila ka ndryshuar dizajnin duke themeluar vetëm një dhomë të veçantë kushtetuese në kuadër të **Gjykatës Supreme të Kirgistanit**, shkurtimisht flasim për autorizimet themelore të **GJKKir.**

Sipas nenit 83.3 të Kushtetutës, ky organ ka pasur për detyrë të konstatojë:

- nëse ligjet dhe aktet tjera juridike ishin në kundërshtim me Kushtetutën;
- zgjidhjen e konflikteve lidhur me efektet, zbatimin dhe interpretimin e Kushtetutës;
- përcaktimin nëse zgjedhjet për President të Republikës kanë qenë të vlefshme;
- gjykimin lidhur me heqjen nga detyra të presidentit të Republikës, gjyqtarëve të **GJKKir**, të Gjykatës Supreme, si dhe të Gjykatës së Lartë të Arbitrazhit;
- gjykimin lidhur me amendamentet dhe ndryshimet në Kushtetutën e Republikës;
- anulimin e vendimeve të organeve të vetëqeverisjes lokale, të cilat nuk janë në pajtim me Kushtetutën; dhe
- dhënien e vendimeve lidhur me kushtetutshmërinë e praktikave të zbatimit të ligjeve të cilat afektojnë të drejtat kushtetuese të qytetarëve.

Vendimet e **GJKKir**, sipas nenit 83.4 të Kushtetutës, kanë qenë të detyrueshme për të gjithë dhe nuk kanë mundur të jenë objekt ankimimi. Ligjet respektive kushtetuese që kanë normuar organizimin dhe funksionimin e saj nuk i kanë dhënë kompetenca shtesë. Një kohë të gjatë ky organ ka pasur emër të mirë, mirëpo më vonë, në veçanti në periudhën prej përgjatë viteve 2005-2010, ka marr anën e dy presidentëve të kompromet uar dhe ka prishur konceptet kushtetuese mbi ndarjen dhe balansimin e pushteteve.

Kjo sjellje e saj bëri që në vitin 2010 të nxirren disa dekrete qeveritare për të reformuar sistemin kushtetues në **Kirgistan**. Ndër to ka qenë edhe dekreti VP Nr. 2 i datës 12 prill 2010 mbi reformimin e **GJKKir**. Me këtë dekret u suprimua **GJKKir** si pasojë e punës së saj joprofesionale dhe animit kah autoriteti i presidentit të vendit, duke ia njohur atij pushtetet arbitrare kundrejt pushteteve të tjera. Kjo bëri që më Kushtetutën e vitit 2010 të vijë deri te depresidencializmi i këtij vendi përmes bartjes së kompetencave nga presidenti i vendit në parlament. Krahas ridefinimit të marrdhënieve në mes të legjislativit dhe ekzekutivit të vendit ka ndodhur edhe themelimi i këtij lloj këshilli kushtetues, një organi të ri për mbrojtjen e kushtetutshmërisë në vend me juridiksion të ndarë, por me kompetenca më të qarta dhe më një pozitë më ndryshe se ish pararendësi i tij, pozitë të cilën e abuzoi deri në vetëshkatërrim në prill të vitit 2010. Ky lloj këshilli kushtetues u quajt **Dhoma Kushtetuese e Gjykatës Supreme të Republikës së Kirgistanit (DHKGJSKir)**

DHKGJSKir është themeluar bazuar në nenit 93.1 të Kushtetutës së vitit 2010, aktualisht në fuqi.[75] Kjo kushtetutë ka qenë objekt i "kontrollit kushtetues profesional" nga ana e **Komisionit**

[75] *Constitution of Kyrgyzstan of 2010.* Në internet: 2010 https://www.constituteproject. org/ constitution /Kyrgyz _ Republic_2010. pdf?lang=en (shikuar në korrik 2017).

të Venecias dhe ka marrë një notë mjaft pozitive, duke marrë parasysh ngjarjet dhe kaosin kushtetues të krijuar në këtë vend në një kohë prej disa viteve, me fillim nga viti 2005.[76] Jo të gjitha pjesët e saj, megjithatë, kanë pasur një status të tillë: pjesa për abrogimin e **GJK-Kir** dhe kalimin e kompetencave të kontrollit të kushtetutshmërisë në një dhomë të veçantë brenda **Gjykatës Supreme** ka qenë objekt i kritikës së veçantë të Komisionit. Kjo kritikë është bërë për arsye se Komisioni, në parim, avokon krijimin dhe ruajtjen e gjykatave të ndara kushtetuese, tradicionale dhe klasike të tipit **evropian/kelsenian**, ani se nuk ka një praktikë të përgjithshme në nivel evropian. Këto vërejtje të Komisionit nuk janë marrë parasysh nga autoritetet e popullit të **Krigistanit** ashtu që në Kushtetutë aktualisht figuron si organ i mbikëqyrjes së kushtetutshmërisë dhoma kushtetuese si më sipër, e cila, megjithatë, ka kompetenca kryesisht të njëjta me ato që pasur **GJKKir**.[77] Analizimit të kompetencave dhe natyrës së kësaj dhome i kthehemi në rreshtat në vijim.

Seksioni I ["Fondamentet e Rendit Kushtetues"] i Kushtetutës flet për fundamentet e rendit kushtetues, nisur nga përvoja e hidhur në të kaluarën. Në kuadër të këtyre fundamenteve të këtij rendi gjenden postulatet si sundimi i ligjit, demokracia e popullit dhe qytetarit, ndalimi i uzurpimit të pushtetit dhe, mbi të gjitha, supremacia (epërsia) e Kushtetutës dhe zbatimi i drejtpërdrejtë i saj. Këtë të fundit nuk e gjejmë në kushtetutat e vendeve të tjera të **Azisë Qendrore**. Mbi bazën e këtij postulati është draftuar edhe juridiksioni i **DHKGJSKir**.

Vendosja e saj në kuadër të **Gjykatës Supreme** flet shumë për një rrethanë: mosbesimin e këtij vendi në gjyqësinë klasike kushtetuese të udhëhequr nga gjyqtarët e rinj dhe me përvojë të re akademike, më shumë se me përvojë nga e kaluara gjyqësore sovjetike. Roli dhe pozita e dhomës përcaktohen me dispozitat kushtetuese që gjenden në kuadër të seksionit VI ["Pushteti Gjyqësor në Republikën e Kirgistanit"] të Kushtetutës. Sipas këtyre dispozitave, ajo është autoriteti më i lartë gjyqësor në vend dhe ushtron në mënyrë të pavarur mbikëqyrjen kushtetuese përmes procedurave kushtetuese.[78] Në rastet kur ligjet dhe aktet tjera normative e juridike bien në kundërshtim me Kushtetutën, **DHKGJSKir** ka autorizim që të njëjat t'i shpallë si jokushtetuese.[79] Përveç këtij kontrolli abstrakt, ajo ka autorizime për të dhënë mendimin e vet lidhur me kushtetutshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare para hyrjes së tyre në fuqi (kontrolli preventiv i kushtetutshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare).[80] **DHKGJSKir** jep mendim edhe lidhur me kushtetutshmërinë e draft ligjeve me të cilat bëhet ndryshimi i Kushtetutës (kontrolli preventiv i amendamenteve kushtetuese).[81]

Ndër kompetencat më të rëndësishme të **DHKGJSKir**, që meriton të veçohet me këtë rast, ka të bëjë me **ankesën kushtetuese.** Në sistemin kushtetues të **Kirgistanit**, ekziston **aneksa jo e plotë kushtetuese**, për shkak se i referohet vetëm bazës juridike të vendimmarrjes, e cila mund të ketë qenë shkaktar i cenimit të të drejtave dhe lirive kushtetuese. Kjo shprehimisht thuhet në nenin 97.7 të Kushtetutës. Kjo dispozitë thekson se "[...] çdokush ka të drejtë të sfidoj kushtetutshmërinë e një ligji apo të ndonjë akti juridik normativ kur beson se aktet në fjalë cenojnë të drejtat dhe liritë e njohura me Kushtetutë".

Ligjet tjera që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e **DHKGJSKir,** të cilat i implementojnë dispozitat kushtetuese për funksionalizimin e saj, nuk parashikojnë

---

[76] EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION), *OPINION ON THE DRAFT CONSTITUTION OF THE KYRGYZ REPUBLIC.* Opinion No. Opinion no. 582 / 2010. CDL-AD(2010)015 (version published on 21 May 2010) Adopted by the Venice Commission at its 83rd Plenary Session (Venice, 4 June 2010).

[77] Cf. paragrafi 6 ["Seksioni VI: Gjyqësori"] i Opnionit nr. 582 të Komisionit, cituar si më sipër.

[78] Cf. neni 93.2 i Kushtetutës.

[79] Cf. neni 97.6.1 i Kushtetutës.

[80] Cf. neni 97.6.2 i Kushtetutës.

[81] Cf. neni 97.6.3 i Kushtetutës.

kompetenca shtesë. Prandaj edhe nuk i kemi diskutuar në këtë seksion, nisur nga fakti se, si të tilla, ato janë të ngjashme me ligjet tjera që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e organit kushtetues në nivel nacional që ka për autorizim ruajtjen dhe sigurimin e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës përmes interpretimit të tekstit të saj dhe dhënies së vendimeve për çështjet që kanë të bëjnë me rendin kushtetues nacional dhe integritetin e tij.

Kushtetuta e Republikës së Taxhikistanit (1994) ka krijuar bazën juridike për formimin dhe zhvillimin e një numri të institucioneve dhe organeve politike dhe shtetërore. Në këtë grup hyn edhe formimi i **GJKTa**, si një organ i specializuar për kontroll të kushtetutshmërisë.

Pavarësia shtetërore e këtij vendi është shpallur më 24 gusht 1990, me nxjerrjen e **Deklaratës mbi Sovranitetin e Republikës së Taxheksitanit**. Apeli i Sovjetit Suprem të Taxhekistanit i 9 shtatorit 1991 mbi Pavarësinë e Republikës së Taxheksitanit paraqet një dokument tjetër mjaft të rëndësishëm për konsolidimin e pavarësisë së këtij vendi dhe shkëputjen definitive nga ish-**Bashkimi Sovjetik**. Nxjerrja e **Kushtetutës së Taxhekistanit**, megjithatë, nuk ka ndodhur menjëherë: vetëm me referendumin nacional të datës 6 nëntor 1994, u bë e mundur miratimi i tekstit të Kushtetutës aktuale.[82] Me këtë edhe u instalua gjyqësia kushtetuese e llojit evropian/kelsenian. Të shohim më nga afër fizionominë dhe përmbajtjen e juridiksionit të saj.

Sipas nenit 84.1 ["Gjykatat"] të Kushtetutës, **GJKTa** paraqitet si një ndër autoritetet gjyqësore nacionale, krahas gjykatës supreme, gjykatës së lartë ekonomike, gjykatës ushtarake dhe gjykatave të tjera më të ulëta në nivel provincial dhe lokal. Ky organ, pra, trajtohet në kuadër të dispozitave për gjykatat në përgjithësi dhe merret si pjesë e sistemit gjyqësor nacional.

GJKTa është e pavarur dhe përgjegjëse për të kryer kontrollin e kushtetutshmërisë në vend. Ky kontroll kushtetues përfshinë, sipas nenit 89.3 ["Gjykata"] të Kushtetutës, këto prerogativa:

- kontrollin abstrakt represiv të ligjeve dhe akteve të tjera juridike të parlamentit qendror, të parlamentit provincial, të akteve të presidentit dhe të qeverisë, të akteve të gjykatës supreme dhe të gjykatës së lartë ekonomike, si dhe akteve e organeve të tjera shtetërore dhe shoqërore, si dhe kontrollin kushtetues preventiv të marrëveshjeve ndërkombëtare të Taxhekistanit, para hyrjes së tyre në fuqi;
- zgjidhjen e konfliktit për kompetencë në mes të organeve shtetërore; dhe, së fundi,
- kryerja e punëve tjera të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligje.

[82] *Constitution of Tajikistan of 1994 with Amendments through 2003*. Në internet: https://www. constituteproject. org/constitution/Tajikistan_2003.pdf?lang=en (shikuar në korrik 2017).
Për historinë kushtetuese dhe aspketet tjera të këtij vendi, si dhe të vendeve tjera të **Azisë Qendrore**, shih më shumë në Scott Newton, *The Constitutional Systems of the Independent Central Asian States: A Contextual Analysis (Constitutional Systems of the World)* **(**Hart Publishing: Oxford and Portland, Oregon, 2017) (ku autori flet për këto çështje: klientelizmin dhe tribalizmin e shoqërive të **Azisë Qendrore**; për faktorët tjerë ekstra-kushtetues që ndikojnë në jetën juridiko-kushtetuese e këtyre vendeve; për rolin gjithnjë prezent të Rusisë dhe trashëgimisë së saj juridiko-kushtetuese, për tranzicionin e vështirë dhe për forcat ideologjike që kanë ndikuar në këtë tranzicion, krahas forcave të tregut global; për ndarjen e pushteteve dhe për presidencializmin galopant që vështirë se mund të reduktohet në një sistem qeverisjeje që mundëson ndarjen dhe balancimin e pushteteve, ashtu siç këto vende e parashikojnë në kushtetutat e tyre; për gjyqësorin e dobët që nuk ka arritur në këtë vend të sigurojë, jo vetëm ndarjen e pushteteve, por edhe ruajtjen e pozitës së individit në shoqëri nga ndërhyrja e organeve të shtetit; për ekonominë liberale në kuptimin e këtyre vendeve; dhe, në fund fare, autori diskuton për identitetin etno-nacionalist të pesë ish republikave sovjetike të **Azisë Qendore**, i cili është zhvilluar gjatë ish-**Bashkimit Sovjetik**, si dhe për ndikimet e mëvonshme kulturore dhe ndikimet tjera në promovimin e një identiteti të ri nëpër secilin nga këto vende).

Ligji që normon veprimtarinë dhe punën e kësaj gjykate quhet **Ligji mbi Gjykatën Kushtetuese të Taxhekistanit**, i nxjerrë për herë të parë më 1995, i cili ka ndryshuar dhe është zëvendësuar me ligjin me të njëjtin emër të vitit 2014, aktualisht në fuqi.[83] Ky Ligj ka qenë objekt vlerësimi nga ana e **Komisionit të Venecias.**[84]

Ligji ka zgjeruar dukshëm kompetencat e **GJKTa**. Tri janë aspektet më të rëndësishme të këtij zgjerimi.[85] Aspekti i parë ka të bëjë me amendamentet kushtetuese: përveç atyre të parashikuara me nenin 89. 3 të Kushtetutës, sipas nenit 34.3 ["Kreu 7: Kompetencat e Gjykatës Kushtetuese të Taxhekistanit"] të Ligjit, ajo ka kompetencë edhe për kontrollin kushtetues të amendamenteve të propozuara kushtetuese. Ky kontroll preventiv i projekt-amendamenteve kushtetuese bëhet duke pasur për pikë referimi dhe standard vendimmarrjeje nenin 100 ["Procedura për Amendamentimin e Kushtetutës"] të Kushtetutës, i cili përcakton se "forma republikane e qeverisjes, integriteti territorial, qeverisja demokratike laike e bazuar në ligj, si dhe natyra sociale e shtetit janë të pandryshueshme".

Zgjerimi i dytë ka të bëjë me **ankesën kushtetuese**. Në dy paragrafët e fundit të nenit 40.1 ["Subjektet që kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese të Taxhekistanit"] të Ligjit, për shkak të cenimit të të drejtave dhe lirive kushtetuese të shkelura me një akt individual apo të përgjithshëm të një autoriteti publik, si palë të autorizuara përcaktohen personat fizik dhe entitetet tjera juridike.

Zgjerimi i fundit që ka rëndësi të diskutohet këtu, ka të bëj me **kontrollin incidental**: sipas nenit të njëjtë, kompetenca e dhënë me paragrafin e fundit ka të bëjë me të drejtën e gjykatave të të gjitha niveleve për të ngritur çështjet e kontrollit incidental me qëllim të vlerësimit të kushtetutshmërisë së akteve të përgjithshme juridike dhe akteve të tjera që duhet t'i zbatojnë me rastin e vendosjes apo zgjidhjes së një rasti apo mosmarrëveshjeje konkrete.

Vendimet dhe aktet tjera të **GJKTa** të dhëna në ushtrim të kompetencave të saj brenda juridiksionit të përcaktuar kushtetues janë përfundimtare.

Në **Uzbekistan,** gjykata kushtetuese gjithashtu paraqitet si një organ i autoritetit gjyqësor që vendos lidhur me kushtetutshmërinë e akteve juridike të ligjvënësit dhe ekzekutivit të këtij vendi. Pas shpalljes së pavarësisë më 30 gusht 1991, vitin në vijim, më 8 dhjetor 1992, **Uzbekistani** nxori kushtetutën e vet të parë.[86] Në kapitullin XXII ["Autoriteti Gjyqësor në Republikën e Uzbekistanit"] të Kushtetutës, **GJKUz**, njëjtë si në rastin e **Taxhekistanit**, futet në kuadër të sistemit gjyqësor nacional dhe figuron si instanca më e lartë. Kjo, megjithatë, asnjëherë nuk duhet të kuptohet se bëhet fjalë për një gjykatë instancionale, pra nuk duhet kuptuar sikur **GJKUz** është instancë e fundit gjyqësore në nivel nacional. Kjo është kështu sepse juridiksioni i saj është ekskluzivisht juridiksion kushtetues, i ndarë dhe i veçantë nga çdo juridiksion tjetër i gjykatave të rregullta (përfshirë në mesin e tyre gjykatat që kanë juridiksion të specializuar në çështjet jo kushtetuese, si p.sh. shembull në lëmin ekonomik, të tregtisë së jashtme, ushtarake etj.).

Kjo rrethanë, pra ky definim klasik dhe tradicional i gjyqësisë kushtetuese si juridiksionale, si një veprimtari e veçantë dhe e ndarë nga juridiksionet tjera brenda gjyqësorit nacional, bëhet e qartë

---

83 КОНСТИТУЦИОННЫЙ ЗАКОН РЕСПУБЛИКИ ТАДЖИКИСТАН О КОНСТИТУЦИОННОМ СУДЕ РЕСПУБЛИКИ ТАДЖИКИСТАН (Ведомости Маджлиси Оли Республики Таджикистан 1995 год, № 21, ст.223; Ахбори Маджлиси Оли Республики Таджикистан 1997 год, №9, ст.110; 1998 год, №10, ст. 111, 115; 2000 год, №6, ст.349; 2001 год, №4, ст.200; 2004 год №2, ст.43; 2006 год, №3, ст. 142; 2007 год, №7, ст.650; 2008 год, №3, ст. 180, №10, ст.794; 2009 год, №7-8, ст.488; 2011г, №6, ст. 427; ЗРТ от 19.03.13г. №935). Në internet:file:///C:/Users/Administrator/Doënloads/Tajikistan_const_law_Constitutional_Court_2014_am2015_ru.pf (shikuar në korrik 2017).

84 EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION), *OPINION ON THE DRAFT CONSTITUTIONAL LAW ON THE CONSTITUTIONAL COURT OF TAJIKISTAN*. OPINION NO. 765/2014 *CDL-REF(2014) 013* (Strasbourg 10 April 2014).

85 Për tjerat, shih më shumë në raportin e Komisionit të Venecias, si më sipër, paragrafet 4-44.

86 *Constitution of Uzbekistan of 1992 with Amendments through 2011*. Në internet: https://www.constituteproject. org/constitution/Uzbekistan_2011.pdf?lang=en (shikuar në korrik 2017).

me nenin 108.1 të Kushtetutës, për dallim nga rasti i **Taxhekistanit**, ku vetëm **Ligji mbi Gjykatën Kushtetuese** dhe jo Kushtetuta, e definon fizionominë e gjyqësisë kushtetuese. Ky nen definon **GJKUz** si një organ që "[...] vendos për rastet e kushtetutshmërisë së akteve të autoriteteve legjislative dhe ekzekutive".

Si i tillë, vlen të theksohet se ky organ nuk është themeluar në një vakum: akoma para pavarësimit të vendit nga ish-**Bashkimi Sovjetik** ka ekzistuar një ligj mbi organet e mbikëqyrjes kushtetuese. Ky kontroll kushtetues ka qenë politik dhe është ushtruar nga ana e një komiteti, **Komitetit për Mbikëqyrjen Kushtetuese në Republikën e Uzbekistanit**, i cili ka qenë nën urdhrat e parlamentit uzbek. Komiteti ka pasur një rol këshillues dhe ka mbrojtur jo vetëm kushtetutshmërinë, por edhe ligjshmërinë, duke u dhënë organeve që kanë nxjerrë aktin jokushtetues apo joligjor një afat dymujor për ta përmirësuar dhe për ta sjellë të njëjtin në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin respektiv. Përveç subjekteve të autorizuara për vënien e tij në lëvizje, Komiteti ka mundur të vihet në lëvizje edhe me vetiniciativë.

Komiteti ka ushtruar detyrat dhe funksionet e tij deri me 22 dhjetor 1995, kur u themelua **GJKUz**, ani se Kushtetuta, e cila përcaktonte krijimin e saj, ishte miratuar më 1992, kurse **Ligji për Gykatën Kushtetuese të Uzbekistanit** që nxjerrë më 30 gusht 1995.[87]

T'i kthehemi sërish juridiksionit kushtetues të **GJKUz**. Në fakt, përveç me Kushtetutë, juridiksioni përcaktohet edhe me një ligj që normon organizimin dhe funksionimin e saj, si dhe me disa ligje të tjera, njëjtë si në rastin e Kosovës që përcaktohet se juridiksioni shtesë i Gjykatës Kushtetuese mund të përcaktohet me ligj (neni 113.10 i **Kushtetutës së Kosovës**, për çka diskutojmë në pjesën për Kosovën dhe juridiksionin e saj në sferën e gjyqësisë kushtetuese).[88]

Pas definimit të kryer në nenin 108.1 të Kushtetutës, i cekur si më sipër, neni 109 më me saktësi bën zbërthimin e kompetencave kryesore të **GJKUz**, të cilat kanë të bëjnë me si vijon:

- përcaktimin e pajtueshmërisë më Kushtetutën të ligjeve dhe rezolutave të dhomave të parlamentit, të dekreteve të Presidentit, vendimeve të Qeverisë dhe të organeve lokale të pushtetit, si dhe të marrëveshjeve ndërshtetërore dhe të detyrimeve tjera të Republikës (paragrafi i parë i nenit 109);
- dhënien e mendimit lidhur me pajtueshmërinë me Kushtetutën të **Kushtetutës së Republikës së Karakalpakstan** (njësi federale uzbeke), si dhe lidhur me pajtueshmërinë e ligjeve të Republikës së Karakalpakstan me ligjet e **Republikës së Uzbekistanit** (paragrafi i dytë i nenit 109);
- interpretimin e normave të Kushtetutës dhe të ligjeve të Republikës së Uzbekistanit (paragrafi i tretë i nenit 109); dhe
- vendosjen lidhur me rastet tjera të referuara për zgjedhje me Kushtetutë dhe me ligje të Republikës (paragrafi i katërt i nenit 109).

Sipas nenit 2 ["Statusi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Uzbekistanit"] të **Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Uzbekistanit,** aktualisht në fuqi,[89] **GJKUz** definohet njëjtë si në nenin 108.1 të Kushte-

---

87 Në fakt, një ligj i veçantë për **GJKUz** ishte nxjerrë qysh më 6 maj 1993. Cf më shumë për **Komitetin për Mbikëqyrjen Kushtetuese**, kompetencat dhe rilin e tij, si dhe për kronologjinë e gjyqësisë kushtetuese uzbeke, themelimin e **GJKUz** dhe zhvillimet pas saj, në veçanti rolin e saj në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në këtë vend, në Amon Mukhamedjanov, "The Role and Place of the Constitutional Court of the Republic of Uzbekistan in Protection of the Human Rights and Freedoms". *Asia Law Quarterly* Vol. 1 No.1 (2009) fq. 179~200 në fq. 185-189.

88 I tillë është ta zëmë, rasti me ligjin uzbek për prokurorinë të vitit 2001 parashikohet mundësi e abrogimit të akteve të këtij organi, përveç akteve individuale, në rast se bien ndesh me Kushtetutën dhe ligjet e **Uzbekistanit**. Cituar sipas Amon Mukhamedjanov, "The Role and Place of the Constitutional Court of the Republic of Uzbekistan in Protection of the Human Rights and Freedoms", fq. 190; Një mundësi e tillë, pra që **GJKUz të ketë kompetencë shtesë edhe përmes ligjeve tjera, pra jo vetëm përmes Kushteutës, përcaktohet edhe në nenin 3 të Ligjit të Uzbekistanit për Gjykatën Kushtetuese**, aktualisht në fuqi (shih fusnotën në vijim).

89 *Law of the Republic of Uzbekistan of May 31, 2017 No. ZRU – 431 About the Constitutional Court of the Republic of Uzbekistan*. (accepted by Legislative House on May 23, 2017 and approved by the Senate on May 27, 2017). Në internet: https://cis-legislation.com/document.fëx?rgn=97595 (shikuar në korrik 2017).

tutës. Ky, megjithatë, nuk është rasti me nenin 4 ["Autorizimet e Gjykatës Kushtetuese"] të Ligjit: në këtë nen, përveç që përsëriten autorizimet e **GJKUz** nga neni 109 i Kushtetutës, shtohen edhe disa kompetenca të tjera të rëndësishme.

Kështu, në ndërkohë që në paragrafin e parë të Ligjit ripërsëritet kompetenca e njëjtë kushtetuese që ka të bëjë me kontrollin abstrakt të përshkruar si më sipër në paragrafin e parë të nenit 109 të Kushtetutës, në paragrafin e dytë të nenit 4 të Ligjit thuhet se **GJKUz** do të jetë kompetente për vendosjen lidhur me kushtetutshmërinë e ligjeve kushtetuese të Republikës si dhe lidhur me kushtetutshmërinë e ligjeve për ratifikimin e traktateve ndërkombëtare para se ato të nënshkruhen nga Presidenti i Republikës.

Paragrafët tre dhe katër të Ligjit po ashtu përshkruajnë kompetencat e **GJKUz** nga paragrafët dy dhe tre të nenit 109 të Kushtetutës, kurse paragrafi i pestë i tij flet për kompetencën e saj në çështjet e kontrollit incidental: këtë kontroll mund ta iniciojnë gjykatat e rregullta vetëm përmes **Gjykatës Supreme të Uzbekistanit** dhe atë vetëm lidhur me aktet normative të cilat ato duhet t'i zbatojnë me rastin e zgjidhjes apo vendosjes së një rasti apo mosmarrëveshje konkrete para tyre, ndërsa kjo vendosje apo kjo zgjidhje varet nga vlerësimi nga ana e **GJKUz** i kushtetutshmërisë së akteve të tilla normative që duhen zbatuar.

Kompetenca e fundit, e cila është shtuar në paragrafin e gjashtë të Ligjit, ka të bëjë me detyrën e **GJKUz** për të raportuar në Parlament dhe te Presidenti i Republikës për gjendjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në vend. Një detyrim të tillë, siç e kemi diskutuar më herët në seksionin e parë të kapitullit të pestë, e kanë pasur gjykatat kushtetuese në kohën e **ish Jugosllavisë.** Këtë lloj kompetence e kanë ruajtur akoma sot e kësaj dite nga ish-republikat jugosllave. Duhet theksuar me këtë rast se kjo kompetencë bie ndesh me rolin dhe fizionominë e gjyqësisë kushtetuese, shkel pavarësinë e saj, duke ia humbur asaj karakterin e gardianit të kushtetutës nisur nga fakti se çdo detyrim për raportim para një organi tjetër e ven gjykatën kushtetuese në pozitë inferiore. Organet shtetërore, siç janë gjykatat kushtetues, i përgjigjen vetëm kushtetutës dhe ligjit, raportojnë para publikut në mënyrë transparente dhe të hapur për çdo vit dhe gjatë tërë kohës. Për më tepër, gjykatat kushtetuese janë pushtet kushtetues, të konstituara me kushtetutë dhe ligje e kjo do të thotë se vetëm nga to nxjerrin legjitimitetin për punën e tyre. Nga ligji, gjykatat kushtetues e nxjerrin legjitimitetin vetëm deri aty dhe përderisa ligji nuk bie ndesh me juridiksionin e veçantë dhe me pavarësinë e tyre juridiksionale të përcaktuar me kushtetutë.

8.4. Vendet e Azisë Juglindore: Indonezia

Për dallim nga vendet e Azisë Juglindore, të cilat i diskutojmë këtu, **Indonezia** ka krijuar gjykatën e saj kushtetuese relativisht vonë, në vitin 2001. Pas fitimit të pavarësisë nga **Holanda**, ky vend ka kaluar nëpër një diktaturë të udhëhequr fillimisht nga **Sukarno** (Achmed Sukarno: 1901-1970), deri në vitin 1967. Në këtë vit, kjo diktaturë u pasua nga diktatura tjetër ushtarake e **Suharto**-s (Soeharto: 1921-2008), e cila përfundoi në vitin 1998 me dorëheqjen e tij. Ideja për një gjykatë kushtetuese indoneziane, megjithatë, daton qysh nga viti 1955. Kjo ide u la nën hijen e ngjarjeve të diktaturës së presidentit **Sukarno** deri në rrënimin e rrezikut komunist në përmasa botërore, nga i cili ky vend qe i afektuar jashtëzakonisht shumë gjatë tërë kohës së **Luftës së Ftohtë** (1947-1991). Me mbarimin e kësaj lufte, **Indonezia** nisi proceset e liberalizimit dhe të demokratizimit, përfshirë edhe kontrollin e kushtetutshmërisë së vullnetit të sovranit: në fillim ky funksion është ushtruar nga **Gjykata Supreme e Indonezisë** (**GJSIn**), pas zgjedhjes asamblesë kushtetuese në vitin 1999. Në vitin 2001, ndërkaq, u bë themelimi **Gjykatës Kushtetuese të Indonezisë** (**GJKIn**). Puna e saj nuk ka nisur deri më 15 tetor 2003. Në këtë datë është bërë kalimi i kompetencave të kontrollit të kushtetutshmërisë nga **GJSIn** në **GJKIn**.[90]

Sistemi gjyqësor indonezian cilësohet nga një lidhje e fortë me traditën civile (kontinentale) të drejtësisë, si pasojë e ndikimit të fort nga ish kolonizatorët holandezë. Ky orientim, megjithatë, ka disa ndryshime: krahas kësaj drejtësie, në këtë vend vlen edhe e drejta e **Sheriatit** si burim i së drejtës, kurse gjykatat

[90] Luca Fanoto, "La giustizia costituzionale negli ordinamenti asiatici (Corea del sud, Mongolia, Taiwan, Indonesia)". Në Luca Mezzetti (ed.), *SISTEMI E MODELLI DI GIUSTIZIA COSTITUZIONALE*, fq. 713-756 në fq.721.

e **Sheriatit** janë në ngarkesë të zbatimit të saj. U mor vesh, kjo ka të bëjë vetëm me çështjet familjare sepse në çështjet tjera vlen e drejta laike. Hierarkia gjyqësore përfundon me **GJSIn**. Në kuadër të këtij sistemi, por vetëm në aspektin formal, hyn edhe **GJKIn**, e cila ka juridiksion krejt të ndarë dhe special në krahasim me autoritetet tjera gjyqësore në vend.[91]

Siç u shënua më sipër, **Sheriati Islam** nuk paraqet burim të së drejtës për të gjitha gjykatat indoneziane, por vetëm për ato fetare. Për këto të fundit ekzistojnë gjykatat fetare që zakonisht janë të ndara në tërësi nga sistemi i gjykatave laike dhe i referohen vetëm çështjet familjare. Kjo e drejtë po ashtu nuk mund të shërbejë si burim i legjislacionit pozitiv indonezian. Kjo bëhet e qartë që në definimin e shtetit, i cili gjendet në nenin 1.3 ["Forma e Shtetit dhe Sovranitetit"] të Kushtetutës ku thuhet në mënyrë krejtësisht të qartë dhe shprehimore se **Indonezia** është një shtet që bazohet në sundimin e ligjit.

Dy janë nenet që në rastin e **Indonezisë** flasin për gjyqësinë kushtetuese, nenet 24 dhe 24C të Kushtetutës.

Neni 24 i Kushtetutës përcakton hierarkinë e gjykatave, me në krye **GJSIn**, e cila pasohet nga gjykatat më të ulëta të juridiksionit të përgjithshëm, si gjykatat fetare, ushtarake, administrative dhe, fare në fund vjen **GJKIn**. **Indonezia** nuk është vetëm në këtë drejtim: më herët në këtë libër kemi folur për vendet në të cilat, në aspektin formal, gjykata kushtetuese futet në kuadër të dispozitave kushtetuese mbi autoritetet gjyqësore nacionale kurse organizimi dhe veprimtaria e saj rregullohet me një ligj të veçantë për gjykatën kushtetuese, pra jo me ligjet organike që i referohen autoritetit gjyqësor nacional si tërësi. Kjo është kështu edhe në **Indonezi**, e cila ka ligj të veçantë për gjykatën kushtetuese, si dhe rregullore të brendshme krahas ligjit.

Natyrisht, në vendet si **Indonezia,** ku gjykata kushtetuese trajtohet në kuadër të gjyqësorit të rregullt, por me kompetencë të ndarë dhe speciale në lëmin kushtetues, lexuesi pret që **GJKIn** të ketë vetëm rregullore të brendshme, kurse pjesa tjetër të normohet me ligjin për autoritetin gjyqësor nacional. Në rastet si këto, pra kur ekziston një ligj organik për tërë gjyqësorin nacional, atëherë zakonisht organizimi dhe funksionimi i gjyqësisë kushtetuese rregullohet me rregullore të brendshme kurse ligji organik për gjyqësorin rregullon aspektet e tjera parimore lidhur me organizimin dhe funksionimin e gjyqësorit nacional. Rast i tillë është, ta zëmë, **Taivani.** Kur gjyqësia kushtetuese ushtrohet nga një gjykatë e ndarë kushtetuese, pa marrë parasysh nëse formalisht figuron në dispozitat kushtetuese mbi gjyqësorin e rregullt, atëherë zakonisht ekziston ligji organik për gjykatën kushtetues, që është e pavarur nga gjyqësori i rregullt në aspektin institucional dhe tjetër. Kur gjyqësia kushtetuese ushtrohet nga një organ i ndarë nga gjyqësori i rregullt dhe që ka juridiksion të qartë dhe të ndarë kushtetues, ani se formalisht figuron në kuadër të dispozitave kushtetuese mbi gjyqësorin e rregullt, një rrethanë e tillë fare nuk ndikon në natyrën e gjyqësisë kushtetuese. Kjo sepse, në rastet e tilla, gjykata kushtetuese ani se trajtohet në kuadër të gjyqësorit nacional, megjithatë, ajo është e veshur me një juridiksion të qartë dhe të ndarë kushtetues, juridiksion që është special në krahasim me gjykatat tjera të kompetencës së përgjithshme (civile, penale dhe administrative) dhe të kompetencës tjetër në çështjet jo kushtetuese. Rast si ky është pikërisht **Indonezia.** Të shohim si duket kjo në kushtetutën e këtij vendi.

Sikundër u pa nga fusnota nr. 91 si më sipër, nenet 24 dhe 25 të Kushtetutës flasin për sistemin gjyqësor indonezian. Nga neni 24, qartë shihet se juridiksioni kushtetues indonezian ka natyrë tipike **kelzeniane/ evropiane**. Ky juridiksion më tutje saktësohet në nenin 24 nën "C" të Kushtetutës. Organizimi, funksionimi, procedurat dhe çështjet tjera rregullohen me **Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Indonezisë.**[92]

---

[91] Nenet 24-25 të kapitulli IX ["Autoritetet Gjyqësore"] i **Kushtetutës së Indonezisë** (1945). *The 1945 Constitution of the Republic of Indonesia As amended by the First Amendment of 1999, the Second Amendment of 2000, the Third Amendment of 2001 and the Fourth Amendment of 2002*. Në internet: http://www. ilo.org/ wcmsp5 /groups/public/---ed_protect/---protrav/---ilo_aids/documents/legaldocument/wcms_174556.pdf.

[92] *LAW NUMBER 24 OF YEAR 2003ON THE CONSTITUTIONAL COURT OF THE REPUBLIC OF INDONEZIA.* (August 2003). Në internet: https://www.ifes.org/sites/default/files/law_no24_constitutional_court.pdf (shikuar në korrik 2017)

Ligji nuk përmban asnjë dispozitë shtesë lidhur me juridiksionin e **GJKIn**, por vetëm kufizohet në rregullimin e çështjeve jo juridiksionale. Kështu, ta zëmë, ne nenin 1 ["Dispozitat e Përgjithshme"] të Ligjit bëhet fjalë për të njëjtat kompetenca që parashikohen në nenin 24 nën "C" të Kushtetutës, të cilat i diskutojmë në vijim.

Vlen të thuhet këtu se, në të shumtën e rasteve, ligjet organike për gjyqësorin e rregullt dhe ato për gjykatën kushtetuese, si ligje të veçanta, zakonisht nuk përcaktojnë kompetenca shtesë për gjykatat kushtetuese: ato vetëm i shtjellojnë kompetencat ekzistuese që normohen me kushtetutën nacionale. Në rastet kur nuk ka një ligj për gjykatën kushtetuese, janë rregulloret e brendshme të gjykatave kushtetuese, të cilat funksionojnë në kuadër të gjyqësorit të rregullt, ato që normojnë funksionimin, organizimin, procedurat e brendshme si dhe çështjet tjera administrativo-organizative dhe financiare. Në rastet ku ekziston një ligj organik për gjykatën kushtetuese nacionale, rregulloret e brendshme shërbejnë si një pikë referimi për lexuesin për të gjykuar për mënyrën e vënies në lëvizje të gjykatës, palët e autorizuara, llojet e vendimeve, anën teknike të buxhetimit dhe çështjet tjera organizative, administrative dhe të procedurës gjyqësore pranë gjykatës kushtetuese. Thënë ndryshe, kur gjyqësia kushtetuese kryhet nga gjyqësori i rregullt, atëherë ligji organik normon çdo aspekt të juridiksionit gjyqësor, përfshirë juridiksionin kushtetues, për shkak se nuk ekziston një ligj i veçantë për gjykatën kushtetuese. Dhe, anasjelltas, aty ku juridiksioni kushtetues ushtrohet nga një organ i ndarë, përkatësisht nga gjykata kushtetuese, atëherë duhet të ekzistojë një ligj i veçantë për të në nivel nacional. Këtu nuk ka rëndësi nëse formalisht kjo gjykatë kushtetuese figuron në kuadër të dispozitave kushtetuese mbi gjyqësorin e rregullt

Ne vijim si më sipër, në **Indonezi**, krahas Ligjit, ekziston edhe një rregullativë e brendshme, **Rregulloria e Gjykatës e Kushtetuese të Indonezisë** e vitit 2005, aktualisht në fuqi. Ky akt normativ specifikon më tutje çështjet e normuara nga Ligji.[93] Në vendet ku nuk ka ligj të veçantë për gjykatën kushtetuese, atëherë vetëm përmes rregullativës së brendshme të gjykatave të rregullta specifikohen detajet e caktuara të funksionimit dhe të punës së seksionit të gjyqësorit të përgjithshëm në rastet kur ai vepron si gjykatë kushtetuese. Ato rregullativa të brendshme, me një fjalë, kanë dispozita të posaçme që vlejnë për rastet kur vendoset për çështje kushtetuese.

Ti kthehemi tani çështjes së **GJKIn**, vendit dhe rolit të saj në sistemin kushtetues indonezian.

Paragrafi i parë i nenit 24 nën "C", i shtuar me amendamentet kushtetuese të vitit 2001, përshkruan kompetencat e **GJKIn**. Në kompetencën e parë, e natyrës origjinale në shkallë të parë dhe të fundit, hyn kontrolli abstrakt i ligjeve. Ky kontroll ka dy anë dhe përfshin jo vetëm kontrollin e legalitetit procedural, por edhe kontrollin e legjitimitetit material të ligjeve. Aspekti i parë ka të bëjë me vlerësimin e legalitetit të ligjeve ashtu siç është përcaktuar me Kushtetutë, përkatësisht me atë nëse është ndjekur procedura kushtetuese për formim të ligjeve. Aspekti i dytë, ndërkaq, ka të bëjë me kontrollin e përmbajtjes së ligjeve me qëllim të konstatimit nëse materja ligjore ka pajtueshmëri me normat materiale kushtetuese (kontrolli i legjitimitetit material të ligjeve).[94]

Palët e autorizuara përcaktohen me akte të tjera juridike, jo me Kushtetutë. Sipas nenit 51 ["Kontrolli Kushtetues i Ligjit kundrejt Kushtetutës"] të Ligjit lidhur me nenin 3 ["Kërkuesi"] të Rregullores si palë të autorizuara për të kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve janë:

- secili person me shtetësi indoneziane apo grup personash që kanë interese të njëjta;
- personat juridik nga e drejta e zakonore nëse parashikohen në ligjin indonezian;
- institucionet publike ose private; dhe, së fundi,
- institucionet e shtetit

---

93 *The Constitutional Court Regulation No. 06/PMK/2005 Regarding Court Proceeding Guidance in Judicial Review Cases.* Published **2005** by Secretariat General and the Court Registry, the Constitutional Court of the Republic of Indonesia in Jakarta. Written in English. *The Constitutional Court of the Republic of Indonesia.* Në internet: https://openlibrary.org/ëorks/ OL5779657Ë/The_Constitutional_Court_regulation_number_06_PMK_2005_regarding_court_proceeding_guidance_in_judici (shikuar në korrik 2017).

94 Cf. Neni 10.1 nën "a" ["Juridiksioni"] lidhur me nenin 4 ["Peticioni"] të Ligjit.

Në te njëjtin paragraf të nenit 24 nën "C" të Kushtetutës gjenden të përshkruara edhe kompetencat tjera të **GJKIn**, të cilat kanë të bëjnë me zgjidhjen e konfliktit për kompetencë, shpërbërjen e partive politike dhe vendosjen lidhur me konfliktet që kanë të bëjnë me rezultatet zgjedhore.

Paragrafi i dytë në vijim i nenit 24 nën "C" të Kushtetutës flet për shkeljet kushtetuese të kryera nga Presidenti apo Zëvendës Presidenti si shkak për largimin e tyre nga detyra. Edhe kjo kompetencë, njëjtë si kompetencat tjera të **GJKIn**, më tutje normohen me Ligj dhe me Rregullore, të cilat përcaktojnë palët e autorizuara, formën dhe përmbajtjen që një kërkesë duhet ta ketë në mënyrë që ajo të mund të shqyrtohet etj. Ajo çfarë bie në sy nga dispozitat e Ligjit dhe Rregullores, është se ato që kanë të bëjnë me formën dhe përmbajtjen e kërkesës, si dhe lidhur me formën dhe përmbajtjen e vendimit lidhur me kërkesën janë jashtëzakonisht të detajuara dhe përcaktojnë, për më tepër, edhe formën dhe përmbajtjen që duhet ta këtë dispozitivi i vendimit të **GJKIn** në rastet kur vendoset për çështjet nga paragrafi i dytë i nenit 24 nën "C" të Kushtetutës.[95]

Fare në fund të diskutimit tonë për **Indonezinë** vlen të përmendim një specifikë të sistemit të saj kushtetues: as Kushtetuta dhe as Ligji nuk kanë ndonjë dispozitë të veçantë që i detyron të autoritetet shtetërore për të respektuar vendimet e **GJKIn**. Në literaturë, kjo vlerësohet si diçka që nuk paraqet ndonjë pengesë sepse ekzekutivi i vendit, Presidenti, ka një detyrë të tillë në mënyrë implicite, e cila rrjedh nga neni 4.1 ["Pushteti Ekzekutiv"] i Kushtetutës. Në këtë nen tregohet se Presidenti "[...] mban pushtetin në pajtim me Kushtetutën [...]". Bazuar në këtë dispozitë, mjaft dubioze, në fillim mendohej se pushteti i zbatimit dhe interpretimit të Kushtetutës i takonte vetëm Presidentit. Pasoja e parë praktike e këtij besimi, në fillim, ka qenë se ka prodhuar një qëndrim negativ ndaj ekzekutimit të vendimeve të **GJKIn**. Më vonë, pas kritikave publike dhe reagimeve të opozitës, kjo pikëpamje ka ndryshuar në tërësi: sot mund të thuhet se **GJKIn** ka një pozitë dhe rol dinjitoz në sistemin kushtetues indonezian dhe paraqet një akter të rëndësishëm në zhvillimin e demokracisë kushtetuese të vendit ashtu asnjë organ kushtetues nuk e konteston autoritetin e saj si një organ i vetëm që ka monopolin për të interpretuar dhe për tu kujdesur për sigurimin e supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës. E thënë ndryshe vendimet e saj kanë karakter të përgjithshëm detyrues (**erga omnes**), fakt që askush nuk e vë në pyetje.[96]

8.5. Vendet e Azisë Juglindore: Koreja e Jugut

Zhvillimi i gjyqësisë kushtetuese në këtë vend të **Azisë Lindore** ka pasur një trajektore mjaft të gjatë dhe të mundimshme. **Gjykata Kushtetuese e Koresë së Jugut** (GJKKJu) është themeluar vetëm në vitin 1987, pas transformimeve kushtetuese të nisura në vitet e para pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore. **Kushtetuta e Koresë së Jugut** e vitit 1987, për herë të parë ka parashikuar themelimin e një gjykate tipike **evropiane/kelseniane**, krahas ekzistimit të gjykatës së ndarë supreme të këtij vendi.[97]

Gjatë viteve të para pas formimit të kësaj gjykate, në këtë vend kanë ekzistuar eksperimente të ndryshme më kontroll kushtetues: në fillim ka pasur një **komitet kushtetues**, tipik për kontrollin politik të kushtetutshmërisë (vitet 1948-1960), i cili është pasuar me instalimin e kontrollit kushtetues të **decentralizuar** apo **difuz** (vitet 1960-1971), për t'u rikthyer çdo gjë sërish në kontrollin kushtetues politik që kryhej nga një **komitet kushtetues** (vitet 1971-1987). Liberalizimi korean i fundviteve '80 të shekullit të kaluar bëri të mundur formimin e kësaj gjykate që shërben si një shembull në atë pjesë të botës dhe më gjerë.[98]

---

95 Cf. Nenet 45-49 të pjesës së shtatë ["Vendimet"] të Ligjit lidhur me nenet 31-43 ["Vendimi"] të kapitullit të shtatë të Rregullores; Vlen të theksohet këtu se Kushtetuta fare nuk ben fjalë për rvendimet dhe natyrën e tyre juridike.

96 Cf. më shumë për këtë, në studimin elokuent të Simon Butt, *The Constitutional Court and Democvracy in Indonezia* (Brill Nijhoff: Leiden and Boston, 2015), në veçanti fq. 60-73 (kapitujt 4 dhe 5 të pjesës së parë të librit, të cilët flasin për llojin e vendimeve dhe obstruksionin qeveritar ndaj vënies së tyre në jetë) dhe fq. 75-117 (kapituj 4 dhe 5 të pjesë së dytë të librit, të cilat flasin për kufizimet e juridiksionit të GJKIn, me ligj si dhe kufizimet që janë vetëimponuar me qëllim të lënies së hapsirës së nevojshme për ligjvënësin për të operuar).

97 *Constitution of the Republic of Korea 1948 with Amendments through 1987.*Në internet:https://www. constituteproject.org/constitution/Republic_of_Korea_1987.pdf?lang=en (shikuar në korrik 2017).

98 Luca Fanoto, "La giustizia costituzionale negli ordinamenti asiatici (Corea del sud, Mongolia, Taiëan, Indonesia)", fq. 717-719.

GJKKJu ekziston ndaras nga sistemi gjyqësor. Në Kushtetutë ka një kapitull të veçantë me tri nene që i dedikohen asaj.[99] Njëjtë si me të gjitha gjykatat kushtetuese që modelohen sipas sistemin **evropian/kelsenian**, në **Korenë e Jugut** ekziston një ligj për **GJKKJu**, i cili është nxjerrë më 1998 dhe është amendamentuar disa herë, herën e fundit duke qenë më 2014. Njëjtë si në shumicën e rasteve të tjera, Ligji përveç që shtjellon më tutje fizionominë e **GJKKJu**, nuk përcakton kompetenca shtesë: ai vetëm e definon tutje rolin dhe pozitën e gjyqësisë kushtetuese koreano-jugore dhe implementon në detaje dispozitat kushtetuese lidhur me kompetencën e këtij organi.[100] Këtë do ta diskutojmë në vijim.

Të shohim njëherë si është përcaktuar fytyra e **GJKKJu** në Kushtetutë, para se të flasim për të njëjtën gjë sa i përket Ligjit.

Në paragrafin e parë të nenit 111 të Kushtetutës radhiten pesë kompetenca të Gjykatës. E para ndër to është mjaft specifike dhe nuk gjendet në listën e kompetencave të gjykatave kushtetuese të tipit të centralizuar (koncentrauar), qoftë me gjykatë të ndarë kushtetuese apo pa të. Fjalën e kemi për **kontrollin incidental të kushtetutshmërisë**: në Korenë e Jugut nuk ka kontroll abstrakt të drejtpërdrejtë të kushtetutshmërisë që iniciohet nga **palët e privilegjuara** (subjektet që nuk kanë nevojë të provojnë ekzistimin e një interesi juridik për të qenë palë në procedurë). Thënë ndryshe, kontrolli i legjitimitetit kushtetues të ligjeve koreano-jugore bëhet përmes rrugës **incidentale** (të tërthortë), e cila mund të iniciohet me kërkesën e palëve apo **ex officio** nga vetë Gjykata.

Kjo procedurë më tutje normohet me Ligj, në veçanti sa i përket palëve të autorizuara: sipas tij, gjykatat e rregullta nuk mund t'i drejtohen **GJKKJu** në mënyrë të drejtpërdrejtë. Këtë duhet ta bëjnë vetëm përmes **Gjykatës Supreme të Koresë së Jugut (GJSKJu).**[101]

Vendimet e **GJKKJu** lidhur me kushtetutshmërinë e ligjit janë vendime të natyrës abstrakte, përkatësisht vlejnë dhe prodhojnë efekte juridik **erga omnes** ndaj të gjithëve, individëve dhe autoriteteve publike në vend, për dallim nga shumica e juridiksioneve të tjera ku vendimet e shqiptuara në procedurat sipas **kontrollit incidental** (të tërthortë) zakonisht kanë efekt **inter partes**.

Kompetenca e dytë e Gjykatës ka të bëjë me konstatimin e përgjegjësisë (**impeachement**) së funksionarëve publikë, prej shefit të shtetit deri te ministrat, kurse kompetenca e tretë lidhet me shpërbërjen e partive politike që kanë veprime dhe objektiva jo kushtetuese. E parafundit prej kompetencave është më klasike dhe lidhet me konfliktin për kompetencë, kurse e fundit fare ka të bëjë më **ankesën kushtetuese.**

Dispozita që ka të bëjë me ankesën kushtetuese gjendet në nenin 111 të Kushtetutës dhe më tutje shtjellohet në nenet 68-75 të Ligjit. Nga leximi i dispozitës kushtetuese nuk mund të nxirret kuptimi i qartë sepse vetëm kuptimi i dispozitës në fjalë nuk është edhe aq i saktë. Në këtë dispozitë thuhet, **inter alia**, se **GJKKJu** vendos "[...] lidhur me peticionet që kanë të bëjnë me Kushtetutën, ashtu siç përcaktohet me ligj". Kjo, pra, nënkupton se Ligji është ai që sqaron se çka mund të jetë objekt i kontrollit kushtetues në një procedurë sipas **ankesës kushtetuese** dhe kush mund të jenë palët e autorizuara. Sa i përket të parës, Ligji thotë se objekt i kontrollit kushtetues mund të jetë çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike koreano-jugore, me përjashtim të aktgjykimeve të gjykatave të rregullta, kurse si palë e autorizuar mund të paraqitet secili person që mendon se me veprime ose mosveprime (ometime) të tilla i janë cenuar të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.[102] Nga kjo sikur del që **ankesa kushtetuese koreano-jugore është ankesë jo e plotë**. Kjo sepse nga formulimi i kësaj dispozite shumë qartë shihet se aktgjykimet e gjykatave të rregullta përjashtohen nga kontrolli kushtetues: ob-

---

99 Nenet 111-113 ["Gjykata Kushtetuese] të Kushtetutës.

100 *CONSTITUTIONAL COURT ACT*, Act No. 4017, Aug. 5, 1988. Në internet: http://ri. ccourt. go. kr/ eng/ ccourt/ files/docs/ news/The_Constitutional_Court_Act.pdf (shikuar në korrik 2017).

101 Cf. neni 41. 1 & 5 ["Kërkesa për Vlerësim të Kushtetutshmërisë së Ligjit"] i Ligjit.

102 Cf. neni 68.1 ["Bazat e Kërkesës"] i Ligjit.

jekt i kontrollit kushtetues mund të jenë vetëm veprimet ose lëshimet (ometimet) e papërcaktuara (jo konkrete dhe të paindividualizuara), të cilat rezultojnë në shkeljen e të drejtave dhe lirive kushtetuese të individëve jo konkret (të papërcaktuar).

Për të ushtruar **ankesën kushtetuese**, individët duhet t'i shterin mjetet tjera juridike të parashikuara me ligjin nacional.[103] Përjashtim nga kjo rregull bëjnë rastet kur pala e njëjtë ka sfiduar kushtetutshmërinë e ligjit të njëjtë në një procedurë incidentale (të tërthortë) si më sipër, mirëpo është refuzuar (ka humbur rastin). Në një situatë të tillë, pala mund t'i drejtohet drejtpërdrejt **GJKKJu**, mirëpo jo më me kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së ligjit që ka qenë objekt shqyrtimi në procedurën për kontroll incidental (të tërthorët), por për shkak të shkeljes së të drejtave dhe lirive kushtetuese si pasojë e veprimit ose mosveprimit (ometimit) të autoritetit të caktuar publik.[104]

8.6. Vendet e Azisë Juglindore: Malejzia

Malejzia, krahas **Singaporit**, bën pjesë në sistemet kushtetuese në të cilat ka pasur ndikim të madh përvoja koloniale nën **Britaninë e Madhe.**[105] Ne këtu, megjithatë, për diskutim kemi përzgjedhur vetëm **Malejzinë**, si një vend me shumicë myslimane në atë pjesë të Azisë. **Singaporin** kemi lënë anash për arsye se sistemi kushtetues i këtij vendi nuk përbën ndonjë veçori të madhe që do ta bënte më ndryshe nga vendet tjera të proveniencës perëndimore të sistemit të së **drejtës së përgjithshme**.[106]

Problemi kryesor në sistemin kushtetues malejzian konsiston në ndeshjen e dy juridiksioneve në çështjen kryesore kushtetuese – mbrojtjen dhe promovimin e lirive dhe të drejtave të garantuara me kushtetutë. Kjo problem ekziston për shkak se në këtë vend, në paralel, bashkëjetojnë dy sisteme të drejtësisë, njëri civil dhe tjetri i bazuar në **Islamin Sharia**. Ai ka lindur në vitin 1988, kur është miratuar amendamenti në nenin 121 ["Pushteti Gjyqësor i Federatës"] të **Kushtetutës së Maljezisë** të vitit 1957, në fuqi me amendamentet e mëpastajme.[107] Deri në këtë kohë, gjykatat malejziane kanë qenë laike dhe kanë pasur një emër të mirë dhe të respektuar në shoqëri.

Sipas këtij amendamenti, juridiksioni i gjykatave federale në **Malajzi** mund të përcaktohet vetëm me ligj. Me këtë stipulim kushtetues, amendamenti në një mënyrë efektive prishi supremacinë (epërsinë) e Kushtetutës, duke e rrënuar rolin e gjyqësorit si sigurues i saj primar. Amendamenti, përveç kësaj, përcaktoi se gjykatat më të ulëta se ato federale, tani e tutje nuk mund të kenë juridiksion në rastet në të cilat ekziston juridiksioni i gjykatave të **Sheriatit Islam**. Ky përcaktim i këtij amendamenti, me fjalë të tjera, i dha ligjit federal të drejtën për të përcaktuar juridiksionin e gjykatave federale në çdo kohë, në ndërkohë që përjashtoi në tërësi gjykatat e nivelit më të ulët se gjykatat federale nga juridiksioni nga çështjet e fesë islame.

---

103 Cf. ibid.

104 Cf. neni 68.2 ["Bazat e Kërkesës"] i Ligjit.

105 Luca Fanoto, "La giustizia costituzionale negli ordinamenti asiatici (Corea del sud, Mongolia, Taiëan, Indonesia)", fq.715.

106 **Singapori** ka fituar pavarësinë e plotë më 1965, dy vite pas bashkimit me **Malejzinë** në një federatë. Sipas **Kushtetutës së Singaporit** të 9 gushtit 1965, në fuqi aktualisht me disa amendamentime, gjykatat fuqishëm mbështesin prezumimin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe sovranitetitn e parlamentit, njëjtë si në **Britaninë e Madhe**. Në nenin 4 ["Supremacia e Kushtetutës"] të Kushtetutës flitet për supremacinë (epërsinë) e Kushtetutës, dhe konstatohet se çdo ligj që bie ndesh me te quhet i pavfleshëm deri në shkallën e mospatujeshëmrisë me Kushteutën. Kjo nënkutpon se, në parim, gjykatat kanë për detyrë të kujdesen për sigurimin e supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës, mirëpo çdoherë duke prezumuar kushtetutshmërinë e ligjit të nxjerrë nga parlamenti.
Në nenin 100 ["Gjyqësori"] të Kushtetutës, përforcohet kujdesi për sigurimin e supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës sepse Presidentit i jepet autorizimi për të kërkuar mendim këshillëdhënës nga **Gjykata Supreme** lidhur me kushtetutshmërinë e ndonjë ligji. Në një rast të tillë, asnjë gjykatë tjetër e vendit nuk mund të sfidojë kushtetutshmërinë e ligjit, i cili ka qenë objekt i mendimit këshillëdhënës si më sipër. Kjo nënkupton se në çdo rast tjetër, gjykatat kanë për detyrë të sigruojnë supremacinë (epërsinë) e Kushtetutës kundrejt çdo ligji. Vlen të theksohet këtu se vetë Kushtetuta ka natyrën dhe cilësinë e ligjit dhe poashtu mund të ndryshohet me ligj, mirëpo me një shumicë të kualifikuar. Cf. *Constitution of Singapore of 1965, with amendments through 1995*. Në internet: http:// www. servat. unibe.ch/icl/sn00000.html (shikuar në korrik 2017). Për komente teorike, shih më shumë në Kevin Y. L. Tan, *Constitutional Law in Singapore* (Kluwer Law International: The Netherlands, 2011), Kapitulli i 6-të ["Gjyqësori"], seksioni 5 ["Kufijt e Kontrollit Gjyqësor"] fq. 113-115.

107 *Constitution of Malaysia of 1957 with Amendments through 2007*. Në internet http://www.agc.gov.my/ agcportal/uploads/files/Publications/FC/Federal%20Consti%20(BI%20text).pdf (shikuar në korrik 2017)

Një sanksionim i tillë kushtetues pat refleksione të mëdha në ndryshimin e orientimit kushtetues të shtetit, i cili deri në atë kohë ishte cilësuar, pa asnjë dyshim, si një **shtet laik** ku supozohej se garantohej liria e praktikimit të feve jo-islame të garantuara me Kushtetutë. Më nuk mund të flitet për garantimin e lirive fetare të garantuara me Kushtetutë dhe as për sigurimin përmes gjyqësorit të supremacisë (epërsië) së Kushtetutës dhe atë për dy arsye: e para, sepse juridiksioni i gjykatave federale mund të ndryshohet me ligj federal në çdo kohë; dhe, e dyta, sepse në çështjet e fesë islame përjashtohet juridiksioni i gjykatave më të ulëta se gjykatat federale; këto çështje tani e tutje gjykohen nga gjykatat e **Sheriatit Islam**.[108] Vendimet e gjykatave të **Sheriatit**, ndërkaq, nuk mund të jenë objekt i kontrollit kushtetues nga ana e gjykatave civile. Kjo gjendje nuk ka qenë kështu para amendamentit të sipërcekur të vitit 1988.

Para këtij viti, gjykatat civile të **Malejzisë** kanë pasur të drejtën e kontrollit gjyqësor ndaj vendimeve të gjykatave të **Sheriatit**. Nga ky vit janë krijuar dy sisteme juridike paralele, një laik dhe tjetri islamik. Kjo, në thelb, nuk është për t'u çuditur dhe mund të thuhet se buron nga përcaktimi i nenit 3 ["Religjioni i Federatës"] të Kushtetutës. Ky nen përcakton mundësinë që, në shumicën e shteteve federale, të ekzistojë një juridiksion islamik për myslimanët, kryesisht në çështjet familjare dhe në ato të besimit islam. Hierarkia e burimeve të së drejtës fare nuk prish punë në këtë mes: në aspektin formal, ligji federal ka përparësi ndaj ligjit të shteteve anëtare të **Federatës së Malajzisë**,[109] kurse Kushtetuta ka epërsi ndaj ligjit federal dhe ligjit të shteteve anëtare.[110] Kjo për shkak se amendamenti, në mënyrë efektive, minoi supremacinë (epërsinë) e Kushtetutës dhe të ligjeve federale në çështjet familjare dhe të besimit islam. Me këtë ka ndryshuar edhe marrëdhënia në mes të Federatës dhe njësive të saj në çështjet e juridiksionit gjyqësor të besimit islam, përfshirë këtu kontrollin kushtetues civil të vendimeve të marra brenda atij juridiksioni. Të shohim si duket kjo në vijim.

Juridiksioni i **Gjykatës Federale (GJFM)** i përcaktuar me Kushtetutë ngelet i varfër. Si autoriteti më i lartë gjyqësor në Federatë, ky organ është arbitër përfundimtar i domethënies së Kushtetutës. Në këtë kontekst, neni 128.1 ["Pushteti Gjyqësor i Federatës"] i Kushtetutës e vesh **GJFM** me juridiksionin origjinal, duke përjashtuar çdo gjykatë tjetër për të vendosur nëse parlamenti nacional apo legjislatura e shtetit anëtar të Federatës kanë tejkaluar autorizimet e tyre kushtetuese. Veç kësaj, ekziston edhe një juridiksion tjetër origjinal në sferën e interpretimit kushtetues: sipas nenit 128.2 ["Pushteti Gjyqësor i Federatës"] të Kushtetutës, **GJFM** po ashtu ka juridiksion origjinal, duke përjashtuar çdo gjykatë tjetër, për të vendosur në lidhje me çdo çështje kushtetuese e cila është ngritur nga një gjykatë tjetër në vend dhe ka arritur tek ajo përmes njërës prej gjykatave të larta në vend (**kontrolli incidental**).[111] Në dy këto juridiksione, siç u tha më sipër, kemi të bëjmë me çështjet kushtetuese që kanë të bëjnë me çështjet civile (jo fetare).

Në çështjet e interpretimit kushtetues që lidhen me **Islamin Sharia** si dhe me interpretimet tjera të dhëna nga gjykatat islamike të të gjitha niveleve nuk vlejnë këto që u thanë më sipër për dy juridiksionet origjinale. Se kjo është kështu, bëhet e qartë nëse lexohet me kujdes teksti i një shtese të amendamentit të sipër cekur në nenin 121 të Kushtetutës. E kemi fjalën për shtesën 121.1 A., e cila përcakton se **GJFM** "[...] nuk do të ketë juridiksion në çështjet që janë nën juridiksionin e gjykatave të **Sheriatit**". Kjo nënkupton se në rastet kur një ligj cenon dispozitat e nenit 128 si më sipër të Kushtetutës, por materia e tij ka të bëjë

---

[108] Hoong Phun Lee, "Constitutional Developments in Malaysia in the First Decade of the Twenty – First Century: A Nation at the Crossroads". Në Albert H. Y. Chen (ed.), *Constitutionalism in Asia in the Early Twnety – First Century* (Cambridge University Press: Cambridge, 2014) fq. 244-269 në. fq247-248; 261-266; 269.

[109] Neni 75 ["Shpërputhjet në mes të Ligjeve Federale dhe Ligjeve Shtetrore"] i Kushtetutës.

[110] Neni 4.1 ["Ligj Suprem i Federatës"] i Kushtetutës.

[111] Juridiksioni nga neni i 128 si më sipër i kësaj gjykate, i cili flet për tejkalimin e kompetencave të Parlamentit Federal dhe të parlameneve lokale si dhe për kontrollin incidental të kushtetutshmërisë, duhet parë në lidhje me dispozitat e nenit 4 ["Ligji Suprem i Federatës"] të Kushtetutës. Ky nen përshkruan në tri paragrafet e para autorizimet e Parlamentit Federal dhe të parlameneteve lokale, tejkalimi i të cilave paraqet bazë për të nisur procedurën e kontrollit kushtetues të ligjeve të tilla të nxjerra në tejkalim të këtyre kompetencave. Në paragrafin e katërt të nenit sqarohet procedura për ushtrim të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve të nxjerra në tejakalim të kompetencae nga tri paragrafet e para. Këto procedura nuk mund të nisen pa lejen e gjyqtarit federal, kurse vetë Federata mund të jetë palë në këto procedura të kontrollit të kushtetutshmërisë.

me çështje fetare që bien në juridiksionin e gjykatave të **Sheritait**, atëherë **GJFM** nuk mund të ushtrojë kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit të tillë, ani se ai mund të jetë nxjerrë në shkelje të dispozitave të nenit 128 të Kushtetutës.

Jashtë këtyre procedurave dhe mekanizmave të kontrollit të kushtetutshmërisë, në nenin 130 të Kushtetutës, në kuadër të kapitullit për gjyqësorin bëhet fjalë për të drejtën e monarkut malajzian që të kërkojë mendim këshillëdhënës prej **GJFM** lidhur me kushtetutshmërinë e një ligji. Në fakt, kjo dispozitë flet për të drejtën e monarkut për të kërkuar mendimin e tillë lidhur me çdo çështje kushtetuese, aktuale apo hipotetike. Kjo dispozitë mundëson që qysh në nisje të pengohet cenimi i Kushtetutës dhe është e ngjashme me dispozitën e diskutuar më herët të nenit 100 të **Kushtetutës së Singaporit.**[112] Kjo ngjashmëri flet më shumë për gjenealogjinë e përbashkët kushtetuese të këtyre dy vendeve se sa për natyrën e kontrollit kushtetues dhe të rolit dhe pozitës së organit përfaqësues në dy vendet. Në rastin e **Singaporit**, supremacia (epërsia) e parlamentit ka kuptimin e ruajtjes së tradicionalizmit konservativ të shtetit laik ashtu që interpretimi i ligjeve në rastet konkrete nga ana e gjyqësorit ka kuptimin e dhënies së përparësisë vullnetit të ligjvënësit dhe prezumimit të kushtetutshmërisë së ligjeve. Ky nuk është rasti me **Malejzinë**: ndikimi efektiv i ligjeve islamike, kohëve të fundit ka spostuar ndikimin e normave kushtetuese, në veçanti kur flitet për liritë dhe të drejtat kushtetuese, duke i vënë jashtë domenit të kontrollit kushtetues të **GJFM** ato norma ligjore që kanë të bëjnë me **Islamin Sharia**.[113]

Lidhur me mendimin këshillëdhënës si më sipër, në **Kushtetutën e Malajzisë** nuk thuhet, mirëpo nënkuptohet, se një ligji që ka marrë një mendim pozitiv nga **GJFM** më nuk mund t'i sfidohet kushtetutshmëria nga të tjerët dhe në asnjë procedurë. Kjo nënkupton, gjithashtu, se ligjet që kanë marrë paraprakisht mendimin pozitiv si më sipër me kërkesën e monarkut, por që kanë natyrë islamike, do të konsiderohen kushtetuese edhe atëherë kur hapur mund të cenojnë të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë. I tillë është rasti me praktikat e **apostazisë** (ndërrim i fesë), të cilat ndalohen rreptësisht kur flitet për braktisjen e fesë islame, ani se me Kushtetutë garantohet liria e praktikimit të fesë dhe besimeve tjera që nuk janë islamike. Që nga rasti i njohur si **Lina Joy** (2007),[114] praktika gjyqësore malejziane e ka bërë të qartë një qasje të tillë.

8.7. Mongolia

Mongolia ka qenë e ndikuar nga ish-**Bashkimi Sovjetik** dhe sistemi i saj juridiko-kushtetues, gati në një mënyrë të njejët si ish-republikat sovjetike të **Azisë Qendrore**, të cilat kanë qenë pjesë përbërse e tij. Për këtë arsye, mbase do të kishte qenë më e udhës që këtë vend ta trajtojmë si të tillë, në kapitullin pararendës ku folëm për ish-**Bashkimin Sovjetik**. Këtë nuk e kemi bërë, megjithatë, nisur nga fakti se, në fund, në këtë vend u përqafua **modeli evropian/kelsenian** i gjyqësisë kushtetuese.[115] Kjo ka qenë arsyeja kryesore që Mongolia trajtohet këtu.

Modeli sovjetik u cilësua si tepër i dobët për të siguruar supremacinë (epërsinë) e **Kushtetutës së Mongolisë** të vitit 1992,[116] aktualisht në fuqi, me të cilën u parashikua themelimi i **Gjykatës Kushtetuese të**

---

[112] Cf. fusnotën 106 si më sipër dhe analizën tonë në tekst.

[113] Cf. Thio Li-am, " 'We are Feeling Our Wat Forward, Step by Step': The Continuing Singapore Experiment in the Construction of Communitarian Constitutionalism in the Twnety – First Century' s First Decate". Në Albert H. Y. Chen (ed.), *Constitutionalism in Asia in the Early Twnety – First Century*, fq. 270-294 në fq. 275; 282-286; 294.

[114] Cf. për komentet dhe analizën e rastit dhe të praktikës gjyqësore maleziane lidhur me këtë në Hoong Phun Lee, "Constitutional Developments in Malaysia in the First Decade of the Tëenty – First Century: A Nation at the Crossroads", fq. 264-266. Kjo nuk ka qenë kështu para vitit 1990 dhe as që ka qenë qëllimi apo synimi i hartuesve të **Kushtetutës së Malejzisë**. Cf. për historinë e draftimit të Kushtetutës në ibid. fq. 261-263.

[115] Cf. Munkhsaikhan Odonkhuu, *Towards Better Protection of Fundamental Rights in Mongolia: Constitutional Review and Interpretation* (Nagoya University: Japan, 2014), kapitulli 3 ["Controlli Kushtetues në Mongoli"] fq. 65-106.

[116] *Constitution of Mongolia of 1992 with Amendments through 2001*. Në internet: https: /www.constituteproject. org/constitution/Mongolia_2001.pdf?lang=en (shikuar në korrik 2017).

Mongolisë, e njohur si **Tsets** (**GJKMon**).[117] Kjo do të thotë se ka qenë modeli i gjyqësisë kushtetuese, me ndikim nga Evropa, ai që ka përcaktuar orientimin tonë për trajtim të **Mongolisë** në këtë seksion të këtij kapitulli. Tek e fundit, ne në këtë libër flasim për gjyqësinë kushtetuese në aspektin komparativ dhe ky ngelet përcaktuesi ynë në strukturimin e librit dhe të krejt diskutimit në te: ka shumë rëndësi, sipas vlerësimit tonë, që lexuesit t'i paraqitet një model kushtetues i ndryshëm nga **Rusia** dhe **Kina,** dy vende me të cilat rrethohet **Monogolia** dhe të cilat kanë pasur një ndikim të madh në jetën kushtetuese dhe politike të vendit përgjatë historisë së kaluar. **Rusia** ka pasur ndikim përmes ideologjisë komuniste, kurse **Kina** për shkak të **Budizmit** dhe traditave të tjera të përbashkëta. Në fakt, traditat e përbashkëta sovjetike dhe kineze reflektohen nganjëherë në mënyrat dhe përvojat e ushtrimit të pushtetit politik në këtë vend. Modeli kushtetues i organizimit të pushtetit dhe mënyrës së kontrollimit të tij, megjithatë, ngelin përcaktues primar për radhitjen e këtij vendi në universin e konstitucionalizmit modern perëndimor. E thënë me fjalë të tjera, në Mongoli ka një gjyqësi kushtetuese që, sado kudo, arrin të luaj një rol të rëndësishëm në frenimin e pushtetit politik dhe sigurimin e një pozite solide të individit në shoqëri. Të shohim si duket kjo në aspektin historik dhe aktualisht, në rreshtat në vijim.

Deri më 1992, **Mongolia** nuk e ka njohur kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe të veprimeve të organeve të pushtetit. Njëjtë si në vendet e tjera ish-komuniste, **Partia Komuniste e Mongolisë (PKM),** në ushtrimin e pushtetit të saj ka vepruar në mënyrë arbitrare. Ajo ka disponuar me pushtet të pakufizuar dhe të pakontrolluar nga askush.[118] Hartuesit e Kushtetutës së vitit 1992, në mënyrë këmbëngulëse dhe të qartë, gjatë procesit të draftimit të saj, theksuan se dëshironin të krijonin një shtet të së drejtës që mbron të drejtat e njeriut nga ndërhyrjet e pushtetit politik, në veçanti nga shumica parlamentare. Këtë ata synonin ta bënin, gjithnjë sipas tyre, duke u siguruar që kushtetuta e re të parashikonte dhe sanksiononte krijimin e një gardiani, të një gjykate kushtetuese, me juridiksion të qartë dhe të ndarë në çështjet kushtetuese, që do të mbikëqyrte zbatimin në praktikë të të gjitha garancioneve kushtetuese.[119] Kjo u arrit nga ata me futjen në Kushtetutë të neneve 64-67 të kapitullit të pestë ["Gjykata Kushtetuese e Mongolisë"], të cilat figurojnë si të ndara nga kapitulli i katërt që flet për gjyqësorin e rregullt mongolez. Të shohim tutje si duket fizionomia e gardianit kushtetues të këtij vendi.

GJKMon definohet si një organ kompetent me autorizim për të ushtruar mbikëqyrjen supreme ndaj zbatimit të Kushtetutës, për të nxjerrë konkluzione lidhur me shkeljen e dispozitave të saj, për të vendosur lidhur me kontestet kushtetuese në vend dhe, në fund, si një organ që shërben si garantues i zbatimit të rreptë të saj. Kjo fizionomi e saj, e stipuluar në nenin 64.1 të Kushtetutës, realizohet përmes

---

117 Sikundër vërehet, ky është rasti i parë që ne japim edhe emërtimin origjinal të gjykatës kushtetuese të vendit që e diksutojmë në këtë libër. Këtë e bëjmë për faktin se kjo fjalë, fjala **Tsets**, në përkthimin ad literam ka një kutim special dhe krjetësisht tjetër dhe jo të gjyktaës kushtetuese, e cila në gjuhën mongole do të ishte Undsen khuuliin shuukh. Vënien e këtij emri krejt specifik hartuesit e Kushtetutës ë vitit 1992 e kanë arsyetuar me faktin se fjala "gjykatë" në diskursin legal mongolez ka prejardhje sovjetike dhe, si e tillë, tingëllon dhe asocon vetëm represion dhe dhunë ndaj popullit të Mongolisë, të cilën e kanë ushtruar gjykatat lkomuniste të modeluara sipas shembullit sovjetik. Për t'i ikur këtij asocimi dhe këtij tingëllimi dhe për të mos rrënuar në fillim autoritein e **GJKMon**, hartuesit e Kushtetutës së vitit 1992 zgjodhën këtë fjalë, fjalën **Tsets.** *Në kulturën mongole kjo fjalë sibolizon një grupim të gjyqtarve tradicionalë që gjykojnë në duelet e mundjes, një sport ky shumë popullor në* **Mongoli**. Me fjalë tjera, **GJKMon** paraqet një institucion tradicional mongolez, i përbërë nga një grup i njerëvze të mençur që vendosin përfundimisht mbi një çështje dhe ku nuk ka mundësi apelimi, një analogji kjo me gjyqtarët e sportit tradicional dhe mjaft të popullarizuar të mundjes në **Mongoli**. Si nocion gjuhësor, ndërkaq, fjala **Tsets** do të thotë **menquri**. Cf. Munkhsaikhan Odonkhuu, *Toëards Better Protection of Fundamental Rights in Mongolia: Constitutional Review and Interpretation,* fq. 79-80 dhe literatura e cituar aty.

118 Edhe në **Mongoli**, njejët si në vendet tjera të ish **Bashkimit Sovjetik** që themeluan të a.q. komitetet e mbikëqyrjes kushtetuese në fund të viteve '80 dhe në fillim tëviteve '90 të shek. 20-të, për të cilat tanimë këmi diksutuar, u pat parashikuar me një amendament kushtetues të vitit 1990 themelimi i këshillit të mbikëqyrjes kushtetuese. Këshilli do të ushtronte kontroll politik të kushtetutshmërisë dhe do të funsiononte në kuadër të Parlamentit, asgjë më shumë. Ai, megjithatë, nuk u themelua asnjëherë nga frika se do të ndërhynte në ruajtjen e monopolitit të pushtetit komunist. Megjithatë, përvoja sovjetike me komitetet e mbikëqyrjes kushtetuese pati ndikim në dizajnin institucional mongolian sepse **GJKMon**, sipas Kushtetutës, ka dy shkallë të procedurës: shkalla e parë ka për qëillim ruajtjen e supremacisë së **Parlamentit të Mongolisë,** kurse e dyta paraqet vendimmarrjen përfundimtare të **GJKMon** lidhur me kushtetutëshmërinë e ligjit. Cf. Munkhsaikhan Odonkhuu, *Towards Better Protection of Fundamental Rights in Mongolia: Constitutional Review and Interpretation*, fq. 66, 68-71, 100-104.

119 Ibid. fq. 66-67.

kompetencave konkrete, të përcaktuara me paragrafët 1 dhe 2 të nenit të saj 66. Në paragrafin e parë flitet për shkeljen e Kushtetutës si bazë për vënien e saj në lëvizje, shkelje e cila iniciohet nga qytetarët me anë të kërkesës apo njoftimit, si dhe sipas kërkesës së Parlamentit, Presidentit të Republikës, Kryeministrit, Gjykatës Supreme dhe Prokurorit të Përgjithshëm.

Kompetenca e parë me qëllim të adresimit të shkeljes kushtetuese si më sipër, sipas paragrafit dy nga i njëjti nen, ka të bëjë me kontrollin **abstrakt represiv të ligjeve dhe akteve e vendimeve të tjera juridike** të Parlamentit, Presidentit dhe Qeverisë, si dhe me **kontrollin represiv të kushtetutshmërisë së traktateve ndërkombëtare**. Kompetenca e fundit, e kontrollit kushtetutës të traktateve ndërkombëtare pasi ato të kenë hyrë në fuqi, paraqet një kompetencë të rrallë, të cilën e kanë vetëm pak shtete (si p.sh. **Polonia**, **Serbia**, etj). Si e tillë edhe është kritikuar nga studiuesit mongolë të gjyqësisë kushtetuese.[120] Kësaj kritike i bashkohemi edhe ne për shkak se, në njëfarë mënyre, përbën "amanet" të arkitektit ideor të gjyqësisë kushtetuese – **Hans Kelsen**, i cili ka qenë fuqishëm kundër kësaj kompetence të gjykatave kushtetuese. Kundërshtimi i tij është bazuar, me shumë të drejtë, në faktin se kjo kompetencë vërtetë përbën një pengesë serioze për bashkëpunim ndërkombëtare në mes të shteteve dhe subjekteve të tjerë të së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

Në sistemin mongolez është e ndaluar ngritja e çështjes së kushtetutshmërisë së ligjit apo normës tjetër juridike nga ana e gjyqësorit të rregullt. Kjo do të thotë se nuk ekziston instituti i **kontrollit incidental**. Për më tepër, **GJKMon** nuk ka të drejtë të bëjë kontrollin e kushtetutshmërisë së vendimeve individuale të gjykatave të rregullta: në këtë vend ekziston, siç do të shihet edhe nga kompetenca e dytë në vijim, por edhe nga kompetencat tjera, vetëm kontrolli abstrakt represiv, i drejtpërdrejtë (jo incidental) dhe i koncentruar i kushtetutshmërisë.

Kompetenca e dytë e Gjykatës ka të bëjë me kontrollin e kushtetutshmërisë së referendumit, veprimeve të Komisionit Qendror Zgjedhor sa i përket zgjedhjes së Parlamentit dhe anëtarëve të tij dhe, së fundi, me kontrollin e kushtetutshmërisë së zgjedhjeve për President të Mongolisë.

Kompetencat në vijim, e treta dhe e katërta, nuk kanë të bëjnë me kontrollin e kushtetutshmërisë së akteve juridike por të veprimeve ose mosveprimeve (ometimeve) të zyrtarëve të lartë shtetërorë në Mongoli: e treta lidhet me vlerësimin nëse Presidenti, kryetari dhe anëtarët e Parlamentit, Kryeministri dhe anëtarët e Qeverisë, kryetari i Gjykatës Supreme dhe Prokurori i Përgjithshëm kanë shkelur Kushtetutën, kurse e katërta ka të bëjë me vendosjen lidhur me ekzistimin e bazës juridiko-kushtetuese për largimin nga detyra të Presidentit, kryetarit dhe anëtarëve të Parlamentit dhe Kryeministrit.

Sa i përket efekteve juridike të vendimeve të **GJKMon**, ekzistojnë disa specifika që e bëjnë shumë të veçantë. Vendimi i saj i dhënë gjatë ushtrimit të kompetencës së parë dhe të dytë i dërgohet Parlamentit për të dhënë mendimin e vet. Nëse ai nuk pajtohet me vendimin, atëherë **GJKMon** nxjerr vendim përfundimtar, i cili është i paapelueshëm dhe i detyrueshëm për të gjithë (**erga omnes**). Kjo procedurë parashikohet me dy paragafët e fundit të nenit 66, paragrafët 3 dhe 4 të Kushtetutës. Ajo më tutje operacionalizohet me dy ligje të tjera, me të cilat vihen në jetë paragrafët e mësipërm kushtetues: **Ligji për Gjykatën Kushtetuese** (1992)[121] dhe **Ligji për Procedurën në Gjykatën Kushtetuese** (1997).[122]

Në literaturë ka pasur mjaft vërejtje për këtë procedurë dyshkalléshe. Kjo për shkak se në modelin **evropian/kelsenian**, gjykatat kushtetuese ushtrojnë kontrollin abstrakt dhe krejt juridiksionin e tyre vetëm përmes një shkalle. Një zgjidhje si kjo nuk përkon me vetë fiziononinë e gjyqësisë kushtetuese të modelit evropian/kelsenian si një vendimmarrëse në shkallë të parë dhe të fundit për të gjitha çështjet kushtetuese.

---

[120] Kontrolli kushtetues represiv i traktateve ndërkombëtare ka qenë objekt kritike edhe i Hans Kelsen, babait të gjyqësisë kushtetuese evropiane. Për rastin e **Mongolisë**, Cf. ibid. fq. 86 dhe komenti i autorit në fusnotën nr. 86.

[121] Cf. Nenin 8.2 ["Mbikëqyrja Supreme ndaj Zbatimit të Kushtetutës"] të Ligjit për Gjykatën. *Law on Constitutional Court (Tsets) of Mongolia of 1992*. Në internet: http://www.conscourt. gov. mn/ shiidver.aspx/shiidver.aspx/?page_id=850&lang=en (shikuar në korrik 2017).

[122] Cf. Nenin 13.1 ["Juridiksioni"] të Ligjit për Procedurën. *The Law on Constitutional Court Procedure of Mongolia of 1997*. Në internet: http://www. conscourt. gov. mn/ news. aspx/ ?page_id=851&lang=en (shikuar në korrik 2017).

Janë dhënë disa arsye për ekzistimin e kësaj procedure mjaft specifike dhe të veçantë. Në rend të parë, është thënë se kjo procedurë mundëson ruajtjen e supremacisë (epërsisë) së Parlamentit si dhe dialogimin në mes të **GJKMon** dhe Parlamentit, një gjë kjo e domosdoshme dhe me shumë dobi për një vend ish-komunist në tranzicion. Arsyeja tjetër ka të bëjë me faktin se gjyqtarët mongolezë shihen në sytë e publikut si të korruptuar në krahasim me Parlamentin si organ suprem ligjvënës.[123] Sido që të jetë, vlen të theksohet se vendimet e **GJKMon** janë përfundimtare dhe dallojnë nga zgjidhjet që dikur i kanë pasur **Rumania**, **Polonia** dhe **Portugalia**, ku parlamenti nacional kishte të drejtë të përmbysë verdiktin e gjykatës kushtetuese me një shumicë të kualifikuar të anëtarëve të vet. Këtu, në rastin mongolez, nuk flitet për këtë situatë por vetëm për një lloj dialogimi në mes të këtyre dy institucioneve shtetërore. Kjo për arsye se, sa i përket kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë, fjalën e fundit gjithnjë e ka **GJKMon**.

Në këtë vend ekziston **actio popularis,** e cila mund të paraqitet jo vetëm nga zyrtarët shtetërorë por edhe nga çdo individ. Ky mjet juridik, në Kushtetutë cilësohet njëherë si "peticion" dhe herën tjetër si "informacion" që mund të paraqitet nga secili individ.[124] Nuk ka ndonjë dallim të madh në mes të tyre. Në literaturë thuhet se procedura për vlerësim të kushtetutshmërisë niset më një njoftim, pa pasur ndonjë interes konkret juridik, përkatësisht pa pasur ndonjë rast konkret të prekshëm të cenimit të të drejtave individuale kushtetuese. Nuk ndryshon esencën e këtij mjeti juridik nëse theksojmë se, në rastin e peticionit, bëhet fjalë për situatat në të cilat një qytetar ankohet për cenim krejt konkret të lirive dhe të drejtave të garantuara me Kushtetutë. Në të dy rastet, fjala është për **actio popularis**, jo për **ankesë kushtetuese**, për arsye se me këto dy trajta të këtij mjeti juridik në dispozicion të secilit qytetar mund të niset vetëm kontestimi i kushtetutshmërisë së ligjit apo i normës tjetër të përgjithshme në nivel abstrakt dhe pa pasur nevojë të dëshmohet ekzistimi i interesit konkret për përdorim të këtij mjeti. Siç u tha më herët, askush nuk mund të kontestojë kushtetutshmërinë e vendimeve individuale të gjykatave të rregullta dhe kjo përbën një hendikep të madh të gjyqësisë kushtetuese mongoleze në sferën e mbrojtjes së lirive të dhe drejtave të njeriut.[125]

8.8. Vendet tjera aziatike: Kina, Tajvani dhe Japonia

Këto dy vende kanë një gjë të përbashkët kur flitet për gjyqësinë kushtetuese: asnjëra prej tyre nuk ka një gjykatë të ndarë kushtetuese. Çdo gjë tjetër pos kësaj është e ndryshme.

Kina moderne nuk ka ndonjë traditë të sundimit të ligjit, përkatësisht të ndonjë teksti juridik që mishëron idenë perëndimore mbi supremacinë (epërsinë) e tij kundrejt çdo gjëje tjetër që ka natyrë të pashkruar, përfshirë këtu supremacinë (epërsinë) kundrejt ideologjisë apo traditës nacionale. Kushtetuta dhe ligji si autoriteti më i lartë në vend dhe si garancion i të drejtave të individit kanë qenë koncepte të huaja në këtë vend deri në ditën e sotme.

Në fund të shekullit të kaluar, dinasitia **Qing**, dinastia e fundit kineze (1644-1912), provoi ndërmarrjen e disa reformave juridike dhe kushtetuese: **Perandoresha Douvager Xixi** (Doëager Cixi: 1835-1908) nisi modernizimin e sistemit juridik, duke e modeluar atë sipas standardeve evropiane. Shpresa e vetme e dinastisë sonë ngelet nxjerrja e një kushtetute, citohet të ketë thënë ajo.[126] Kjo kohë njihet si koha e kodifikimeve kineze të së drejtës penale, tregtare, civile, familjare dhe, pjesërisht, kodifikim edhe i të drejtës administrative. Kodifikimet patën një intensitet të paparë më herët. Pjesë e këtij modernizimi ishte edhe themelimi i **Komisionit për Kodifikim,** i cili kishte për detyrë të kujdesej jo vetëm për kodifikimet klasike si më sipër, por edhe për ndryshimet në sistemin kushtetues. Krejt kjo me synim për ta transformuar **Kinën** në një monarki kushtetuese.

---

123 Cf. më shumë për këto dhe arsyet tjera në Munkhsaikhan Odonkhuu, *Towards Better Protection of Fundamental Rights in Mongolia: Constitutional Review and Interpretation*, fq. 97-98.

124 Ibid. fq. 90

125 Ibid. fq. 92-95.

126 Jerome Alan Cohen, "China's Changing Constitution". *Northwestern Journal of International Law & Business* Volume 1 Issue 1 (Spring1979) fq. 57-121 në fq. 59.

Këto reforma juridike dhe kushtetuese mëtonin të sfidonin strukturat institucionale dhe sistemet tradicionale të bazuara në ideologjinë e njohur si **Konfucianizëm** (kodet morale dhe zakonet e vjetra shekullore që kanë mbizotëruar në **Kinë** përgjatë shekujve).[127] Në thelb, që nga koha p.e.s. në **Kinë** ka ekzistuar një tension në mes të **Konfucianizimit** dhe një shkolle të njohur si **Legalizmi**: sipas filozofisë konfucianiste, sundimi duhej të bëhej nga njerëzit dhe vlerat e tyre morale, kurse sipas legalistëve, ai duhej të bëhej jo në bazë të tekeve, virtyteve dhe moralit të njerëzve të caktuar, por në bazë të urdhrave ligjore të paracaktuara më herët.

Për një kohë **Legalizmi** pati një sukses dhe arriti të rrisë fuqinë e **Kinës** perandorake të dinastisë **Chin**. Ky sukses nuk zgjati shumë sepse njerëzit u lodhën nga ndërtimi i murit kinez dhe i punëve publike e represionit që ushtrohej mbi ta: pas njëzet vjetësh, **dinastia Chin** u rrënua dhe sërish u kthye fama e filozofisë jetësore të **Konfucianizmit**. Një dinasti tjetër, **Dinastia Han**, mori përsipër restaurimin e **Konfucianizmit**, duke e ruajtur aparatin administrativ represiv të dinastisë pararendëse. Në literaturë kjo u cilësua si **konfuçianizim i ligjit**, periudhë që ka zgjatur deri në vitin 1912.[128]

Dinastia Qing nuk realizoi premtimin e vet për reforma kushtetuese, duke e koncentruar pushtetin në familjen perandorake dhe duke mos arritur të ndjekë hapin me kohën. Kjo bëri që edhe më shumë të ngrihet ndikimi kolonial në vend, diçka që shpresohej se përmes reformave do të mund të evitohej. Kjo pakënaqësi i solli nacionalistët në pushtet. Pas marrjes së pushtetit të **nacionalistëve kinezë** dhe abolimit të monarkisë më 1912, **Qeveria Kuomintang** u mundua të nxjerrë një kushtetutë të shkruar, por dështoi: ajo që u cilësua si **Kushtetuta e Përhershme e Kinës**, e nxjerrë në vitin 1923, nuk kishte ndikim më larg se periferia e **Pekingut**. As Kushtetuta e Përkohshme e vitit 1931, nuk ishte më e mirë. Kjo për faktin se Partia Nacionaliste, **Kuomintang**-u, e cila kishte përmbysur **Perandorinë e Kinës**, kishte pak vullnet që të nxirrte një dokument të stilit perëndimor për të kufizuar pushtetin e vet. E njëjta vlen edhe për **Kushtetutën e Kinës** të vitit 1946, e cila aktualisht është në fuqi në **Tajvan**, e cila paraqet një kombinim të disa institucioneve të vjetra kineze, siç është rasti me institucionin e **Auditimit** dhe me **Gjyqësorin Yuan.**[129]

Nga kjo që u tha më sipër, shihet se gjendja në **Kinë** deri në marrjen e pushtetit nga komunistët më 1949, ngeli në një gjendje të luftës permanente civile dhe kaosit të krijuar si pasojë e rënies së autoritetit absolut të **Perandorisë së Kinës** dhe luftës për pushtet në mes të pjesëve të shkapërderdhura të shoqërisë kineze. **Kuamintang**-u, njëjtë si dinastia e fundit kineze, nuk arriti të ecë me kohën në fushën e modernizimit dhe ruajtjes së paprekshmërisë së sovranitetit nacional. Kjo gjendje solli në pushtet komunistët më 1949.

Komunistët nxorën disa kushtetuta të shkruara që u modeluan sipas recetave të **marksizëm-leninizmit** mbi unitetin e pushtetit dhe sundimin e partisë komuniste si një avangardë e popullit punues dhe proletariatit. Në këto kushtetuta as që mund të bëhet fjalë për ndonjë ide mbi sundimin e ligjit ku do gjente zbatim supremacia (epërsia) e kushtetutës dhe zbatimi i saj si një instrument për kufizim të pushtetit dhe garantim të të drejtave e lirive individuale. Në të gjitha këto kushtetuta, fjala ka qenë **për përshkrim të pushtetit dhe fuqisë absolute dhe të pakontrolluar të partisë komuniste** si një avangardë e diktaturës së proletariatit, fshatarësisë dhe popullit tjetër punues.[130] Gjendja nuk paraqitet esencialisht më ndryshe as

---

[127] U mor vesh, tërë kjo reformë juridike dhe kushtetuese po bëhej me presion të vendeve perëndimore. Cf. Karla W Simon, *Civil Society in China: The Legal Framework from Ancient Times to the "New Reform Era".* (Oxford University Press: Ocford, 2013) fq. 47-49

[128] Cf. më shumë për këtë periudhë dhe reformat për të modernizuar sistemin juridik kinez në Jyh-pin Fa (with a Foreward by Stephen A. Saltzburg), "A Comparative Study of Judicial Review Under Nationalist – Chinese and American Constitutional Law". *Occasional Papers/Reprints Series in Contemporary Asian Studies* Vol. 33 No. 4 (1980) (School of Law of the University of Maryland) fq. 1-182 në fq. 9-39.

[129] Jerome Alan Cohen, "China's Changing Constitution", fq. 59-62.

[130] Fjala është për kushtetutat e Kinës të viteve 1954, 1975 dhe 1978. Cf. Daniel C. K. Chow, *THE LEGAL SYSTEM OF THE PEOPLE'S REPUBLIC OF CHINA: IN A NUTSHELL* 2nd ed. (West Group: St Paul MN, 2009) fq. 71. Për komentet doktrinare të këtyre kushtetutave dhe gjendjen e " konstitucionalizmit" në Kinë në këtë periudhë, cf. më shumë në Jerome Alan Cohen, "China's Changing Constitution", fq. 62-104.

sipas Kushtetutës së vitit 1982, aktualisht në fuqi dhe trembëdhjetë herë e amendamentuar deri më sot.[131] Viteve të fundit, megjithatë, ka pasur përpjekje nga grupet e interesit dhe lobistë të ndryshëm në vend për të krijuar një sistem kushtetues më të hapur dhe me orientime perëndimore liberale. Këto përpjekje kanë ngecur si pasojë e kontrollit politik të **Partisë Komuniste të Kinës** (PKK) dhe mosgatishmërisë së saj për ta futur pushtetin e saj nën kontrollin e Kushtetutës dhe ligjeve kineze.[132]

Kina, si një bastion i fundit i një vendi të madh komunist, garanton epërsia (supremacia) e Kushtetutës. Për më tepër, në Kushtetutë flitet edhe për vënien e saj në jetë. Kështu thotë Preambula dhe disa dispozita të pjesës operative të Kushtetutës. Kjo, megjithatë, në praktikë nuk ka ndonjë efekt substancial në kuptim të zbatimit të postulateve të konstitucionalizmit perëndimor liberal. Të shohim në vijim si duken këto zgjidhje kineze në aspektin formal.

Preambula ka një narracion interesant sepse flet për historinë e Kinës post-imperiale të shekullit njëzet, duke lavdëruar popullin kinez dhe heroizmin e tij gjatë ndërtimit të komunizmit dhe unitetit të popullit kinez. Në këtë preambulë, **PKK** zë një vend të spikatur: për te flitet si për një avangardë të popullit kinez, kurse pushteti definohet unik dhe i pandarë dhe si një diktaturë popullore komuniste dhe proletare. Vetëm në paragrafin e fundit të Preambulës flitet për supremacinë (epërsinë) e Kushtetutës: aty thuhet se me Kushtetutë afirmohen të arriturat e popullit kinez, definohet sistemi shtetëror dhe detyrat e tij në formën juridike, konstatohet fuqia e saj si ligj fundamental i shtetit dhe si autoriteti suprem juridik. Më tutje, Preambula përcakton se Kushtetuta është normë bazike e sjelljes, të cilën kanë për detyrë ta respektojnë të gjithë pa përjashtim (populli, armata, organet shtetërore, organizatat politike dhe jo politike, individët etj.), ta ruajnë dinjitetin dhe të sigurojnë vënien në jetë të saj.

Përkundër këtij narrativi premtues në shikim të parë, nenet operative nuk ndjekin Preambulën sepse ata më shumë flasin në mënyrë propagandistike për kontrollin politik të Kushtetutës, për supremacinë (epërsinë) e **PKK** dhe të diktaturës së popullit, kujdesin për ndërtimin dhe promovimin e socializmit dhe për ligjshmërinë socialiste. Fare në fund flitet për detyrën për respektim të Kushtetutës, gjithnjë në kontekstin si më sipër të ruajtjes së supremacisë (epërsisë) ideologjike të **PKK**.

Këtë qasje më tutje e gjejmë në mënyrë shumë më të qartë të shprehur në parimet e përgjithshme të Kushtetutës, në veçanti në nenet 1-12, ku parimi i **diktaturës popullore** dhe i **centralizmit demokratik socialist** vihen në spikamë shumë lartë, kurse prona publike cilësohet si e shenjtë dhe e paprekshme, kurse sabotimi ndaj sistemit socialist përbën një vepër të rrezikshme penale dhe kushtetuese. Në nenin e pestë të parimeve të përgjithshme theksohet se çdo cenim i Kushtetutës dhe ligjeve duhet të hetohet. Këtu, pra, flitet për hetimin si një kategori tipike në vendet diktatoriale, jo për kontroll të kushtetutshmërisë së veprimeve të organeve shtetërore dhe akteve të tyre.

Vendi dhe roli i individit në shoqërinë kineze definohet në një mënyrë të qartë në formulimet e kapitullit të dytë të Kushtetutës ["Të Drejtat Fundamentale dhe Detyrat e Qytetarëve"], ku neni 53 urdhëron respektimin e Kushtetutës. Krahas këtij respektimi, ky nen detyron qytetarin që të ketë kujdes të shtuar edhe për ruajtjen e "[…] sekretit shtetëror, pronës publike, disiplinës së punës, rendit publik dhe etikës shoqërore". Këto formulime, tipike komuniste, përmbajnë stipulime kërcënuese dhe propagandistike që shërbejnë si një paralajmërim publik për qytetarët që nuk janë luajal ndaj sistemit kinez komunistë të qeverisjes.

Për kontrollin kushtetues, të një natyre politike merret vesh, flitet shumë vonë në tekstin e Kushtetutës. Për ushtrimin e këtij funksioni ngarkohet organi që është bartës i pushtetit supreme në Kinë.[133] Ky organ, në të

---

131 *Constitution of the people's Republic of China of 1982 through Amendments 2004.* Në internet: https://www.constituteproject.org/constitution/China_2004.pdf?lang=en (shikuar së fundi në gusht 2017).

132 Edward Wong **and Jonathan Ansfieldfeb**, "Reformers Aim to Get China to Live Up to Own Constitution". *New York Times* 2 April 2013. Në internet: http://www.nytimes.com/2013/02/04/world asia/reformers-aim-to-get-china-to-live-up-to-own-constitution.html (shikuar në gusht 2017).

133 Neni 57 ["**Kongresi Popullor i Republikës Popullore të Kinës**"] I Kushtetutës: " Kongresi Popullor i Republikës së Kinës është organi më i lartë i pushtetit shtetëror. Trupi i tij permanent është Komiteti i Përhershëm i Kongresit Popullor".

njëjtën kohë, është edhe organ i vetëm ligjvënës në nivel nacional.[134] Nga redaktimi i dispozitave kushtetuese qartë shihet se vetëm **Kongresi Popullor** dhe **Komiteti i Përhershëm** mund të ushtrojnë kontrollin (politik) të kushtetutshmërisë në vend. Ky kontroll përfshin mbikëqyrjen e vënies në jetë si dhe vetë interpretimin e Kushtetutës.[135] Për të arritur këtë, pra mbikëqyrjen e vënies në jetë dhe interpretimin e Kushtetutës, tri lloje të verimeve duhet të ndërmerren: e para, kontrolli (politik) i kushtetutshmërisë së akteve juridike; e dyta, kontrolli (politik) i kushtetutshmërisë së veprimeve të liderëve; dhe, së fundi, zgjidhja e mosmarrëveshjeve juridiksionale në mes të organeve shtetërore.[136]

Kongresi dhe Komiteti e ndajnë pushtetin e mbikëqyrjes (politike) të kushtetutshmërisë në ndërkohë që interpretimin e Kushtetutës e bën vetëm Komiteti.[137] Adresimi me Kushtetutë i kontrollit politik të kushtetutshmërisë si dhe caktimi i autoritetit shtetëror që kryen interpretimin kushtetues, në literaturë thuhet se ka të bëjë me dëshirën e kinezëve për t'i shmangur tragjeditë e llojit të **Revolucionit Kulturor**, përkatësisht me qëllim të bërjes së pushtetit më human dhe më të parashikueshëm.[138]

Në procesin e kontrollit politik kushtetues në **Kinë**, megjithatë, jo domosdo vjen deri të anulimi i dispozitave jo kushtetuese. Ai anulim mund të ndodhë vetëm nga njëri prej dy organeve të përcaktuara dhe vetëm ndaj disa prej llojeve të normave dhe akteve juridike.

Anulimi i normave dhe akteve juridike mund të bëhet nga ana e Kongresit vetëm atëherë kur flitet për normat apo aktet që gjenden në rregullore, vendime, urdhra dhe akte tjera të qeverisë kineze apo të normave të përgjithshme të organeve të pushtetit lokal të cilat bien në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet qendrore.[139] Sikundër mund të vërehet, nuk parashikohet mundësia e anulimit të ligjeve të nxjerra nga vetë Kongresi: fjala është vetëm për aktet nënligjore në nivel qendror dhe lokal, të cilat kanë natyrë të përgjithshme. Për kontrollin e kushtetutshmërisë (dhe ligjshmërisë) së këtyre akteve nënligjore ekziston një përvojë e gjatë në Kinë, si pasojë e kontrollit centralist të pushtetit nga ana e **PKK**, kurse në vitin 2000, kjo procedurë ka marrë bekimin e ligjvënësit kinez me aktin e nxjerrjes së rregullave të detajuara juridike që normojnë këtë procedurë. Kjo ndryshe njihet si procedura e regjistrimit dhe e kontrollit të akteve nënligjore normative për sa i përket kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së tyre. Sipas kësaj procedure, Komiteti bën regjistrimin dhe kontrollin e çdo akti nënligjor në nivel qendror dhe lokal para shpalljes dhe hyrjes së tyre në fuqi me qëllim të sigurimit se ato akte nuk bien ndesh me Kushtetutën dhe ligjet qendrore kineze.[140]

Kjo qasje është produkt i pashmangshëm i parimit të unitetit të pushtetit, ligjshmërisë socialiste dhe rolit prijës të **PKK** në organizmin dhe ushtrimin e pushtetit në nivel nacional dhe lokal. Kushtetuta parqet një dokument politik i cili më shumë përshkruan dhe sanksionon gjendjen ekzistuese shoqërore dhe

---

134 Neni 58 ["**Kongresi Popullor i Republikës Popullore të Kinës**"] i Kushtetutës: "Kongresi Popullor dhe Komiteti i Përhershëm ushtrojnë pushtetin legjislative të shtetit".

135 Neni 62 ["**Kongresi Popullor i Republikës Popullore të Kinës**"] i Kushtetutës: "Kongresi Popullor ushtron këto funksione dhe pushtete: […] Mbikëqyrë vënien në jetë të Kushtetutës […]"; Neni 67 ["**Kongresi Popullor i Republikës Popullore të Kinës**"] i Kushtetutës: "**Komiteti Permanent i Kongresit Popullor** ushtron këto funksione dhe pushtete: […] Intepretimin e Kushtetutës dhe mbikëqyrjen e vënies së saj në jetë […]".

136 Cai Dingjian, "Constitutional Supervision and Interpretation in the People's Republic of China" *Journal of Chinese Law* Vol. 9 No. 2 (Fall 1995) fq. 219-245 në fq. 227.

137 Sipas Kushtetutës së **Republikës Popullore të Kinës** të vitit 1954, ka ekzsituar po ashtu dispozita përkatëse lidhur me mbikëqyrjejn kushtetuese, ngjashëm më këtë që sot është në fuqi. Dispozita për interpretimin e Kushtetutës nuk ka pasur. Me vonë, në vitet e fundit të **Revolucionit Kulturor** (1966-1976), u nxor **Kushtetuta e Republikës Popullore të Kinës** e vitit 1975. Kjo kushtetutë fare nuk fliste as për mbikëqyrje e as për interpretim kushtetues. Këto dy koncepte u rikthyen sërish në Kushtetutën e vitit 1978 për të evituar dëmet e shkaktuara në kulturën juridike nga **Revolucioni Kulturor** dhe me shpresën e rikthimit të gjendjes së sanksionuar me Kushtetutën e vitit 1954. Cf. më shumë për origjinën dhe shkaqet e këtyre zgjidhjeve kushtetuese të Kinës komunistë në Cai Dingjian, "Constitutional Supervision and Interpretation in the People's Republic of China", fq. 220-223.

138 Ibid. fq. 223.

139 Cf. neni 67 pikat 7 dhe 8 ["**Kongresi Popullor i Republikës Popullore të Kinës**"] I Kushtetutës.

140 Për një analizë të shkëlqyer të kësaj procedure, Cf. më shumë në Guobin Zhu "Constitutional Review in China: An Unaccomplished Project or a Mirage?" *Suffolk University Law Review* Vol. 43 No. 3 (2010) fq. 625 – 653 në. fq. 633-641.

politike sesa një dokument juridikisht të detyrueshëm për tu zbatuar: pas çdo kushtetute të re (apo pas çdo amendamentimi të asaj ekzistuese) çdoherë qëndron një ndryshim i ri socio-politik i cili duhet të reflektohet në tekstin e kushtetutës së re (apo në amendamentin e ri në kushtetutën ekzistuese).[141] Kjo nënkupton se **Kushtetuta e Kinës**, si në çdo vend tjetër komunist, efektivisht shërben ekskluzivisht sa për të shenjtëruar pushtetin unik dhe të pandara të **PKK** si avangardë e popullit punues dhe diktaturës së tij që ushtrohet përmes saj në emër të tyre.[142] Se kjo është kështu shihet qartë nga mënyra e formimit të organeve kryesore të pushtetit kinez: të gjitha nominimet për tu bërë anëtar i Kongresit dhe Komitetit përcaktohen nga **PKK**.[143] Kjo e fundit ka pushtet më të madh se Kongresi dhe Komiteti, ashtu që efektivisht rri mbi Kushtetutën dhe ligjet: çdo kontroll politik kushtetues i veprimeve të saj paraqet një iluzion dhe dëshirë utopike, ani se Kushtetuta në nenin e saj të pestë e vë detyrimin e respektimit të Kushtetutës nga të gjithë, pa asnjë përjashtim.[144]

Ndarja dhe balansimi i pushteteve janë koncepte dhe përvoja tërësisht të panjohura për sistemin kushtetues kinez. Çdo organ i pushtetit krijohet nga Kongresi apo organet e barasvlershme me te në nivel lokal, përfshirë këtu edhe gjyqësorin (në të gjitha nivelet, lokale dhe qendrore).[145] Gjyqësori në **Kinë**, në veçanti **Gjykata Supreme e Republikës Popullore të Kinës** (**GJSRPK**), as që e ka idenë e kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve apo kontrollit të veprimit administrativ të shtetit kinez. Kushtetuta thekson se **GJSRPK** i përgjigjet Kongresit, kurse nivelet tjera të gjyqësorit i përgjigjen organeve të tjera përfaqësuese të barasvlefshme me Kongresin në nivel të pushtetit lokal.[146] Gjyqësori kinez, përfshirë në radhë të parë **GJSRPK,** ka një rol jashtëzakonisht jo qendror në sistemin kushtetues: ai vetëm zbaton ligjet, pa pasur të drejtën e interpretimit të tyre.[147] Këtë të drejtë, të drejtën e interpretimit të ligjeve, e ka vetëm Komiteti.[148]Kjo është diçka e kundërt me

---

[141] Kështu, Kushtetuta e vitit 1954 ka sanksionuar fitoren e komunizmit dhe stabilizimin e pushtetit të partisë – shtet, ajo e vitit 1975, u nxor nga e majta ekstreme, e cila besonte se kishte stabilizuar pushtetin dhe frytet e **Revolucionit Kulturor**, kurse Kushtetuta e vitit 1978 e shpalli të përmbysur dhe të gabuar përvojën me këtë revolucion. E fundit, Kushtetuta në fuqi e 1982, mëton t'i kthejë ditët e mira të viteve '50 të shekullit të kaluar dhe të hedhë poshtë çdo ide të eksteremit të majtë në Kinë, duke besuar se Kina ka një socializëm specific dhe një rrugë të vaçantë të zhvillimit të socializmit. Cf. Ëilliam C. Jones, "The Constitution of the People's Republic of China". *Washington University Law Review* Volume 63 Issue 4 (1985) fq. 707-735 në fq. 711-716.

[142] Thomas E. Kellogg, "Constitutionalism with Chinese Characteristics?: Constitutional Development and Civil Litigation in China". *Indiana University Research Center for Chinese Politics & Business*. *Working Paper No. 1* (February 2008), fq. 1-39 në fq. 2-3.

[143] Brian Barnëell, *Constitutional Law in the People's Republic of China. Chinese Law Paper Series* (Government Law Center of Albany Law School: Albany, NY, 2011) fq. 3-4.

[144] Për mundësitë teorike të realizimit të këtij ideali dhe të kësaj ideje utopike, Cf. më shumë në Cai Dingjian, "Constitutional Supervision and Interpretation in the People›s Republic of China", fq. 227-229.

[145] Neni 3. 3 ["Parimet e Përgjithshme"] I Kushteyutës: " Të organet administrative, gjyqësore dhe prokuroriale të shtetit krijohen nga kongreset popullore, u përgjigjen atyre dhe punojnë nën mbikëqyrjen e tyre".

[146] Cf. neni 128 ["Gjykata e Popullit dhe Prokuroria e Popullit"] i Kushtetutës.

[147] Brian Barnëell, *Constitutional Law in the People's Republic of China,* fq. 172.

[148] Neni 67 pika 4 ["Kongresi Popullor i Republikës Popullore të Kinës"] i Kushtetutës: "[…] Komiteti i Përhershëm ka autorizime dhe pushtete për të […] interpretuar ligjet […]".
Në literaturë, megjithatë, ka përpjekje për të ndërtuar një teori për ekzistimin e gjoja të një sistemi specifik të kontrollit të kushtetutshmërisë në Kinë, duke u bazuar në rastin e vendosur nga Gjykata Supreme, i njohur si **rasti Qi Yuling v. Chen Xiaoqi & Ors** (2001). Sipas kësaj teorie, **GJSRPK**, sipas modelit amerikan të **Marburty vs Madison**, gjoja paska fituar të drejtën në dobi të gjyqësorit kinez për nisjen e praktikës së kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe të kontrollit të veprimit të organeve shtetërore. Ky rast ka pasur të bëjë me sa vijon: një student, **Qi Yuling**, pas shumë vitesh kupton se një student tjetër, Chen, ia ka vjedhur rezultatet e provimit pranues në kolegj dhe ka kryer regjistrimin në dobi të vetin. Studenti **Qin** në momentin e vjedhjes nuk ka pasur as dijen më të vogël për këtë dhe ka besuar se ka rënë në provim dhe se nuk ka merituar të regjistrohej. Kur ka kuptuar, ka paditur në një gjykatë lokale, e cila nuk ka ditur se si të veprojë. Për këtë ka kërkuar ndihmën profesionale të **GJSRPK**. Ky organ menjëherë ka dhënë mendimin e saj, befasues për shumëkend në **Kinë**, me të cilin ka theksuar se e drejta kushtetuese për arsimim e studentit **Qi** është cenuar dhe se për këtë duhet bërë kompensimin civil. Nga ky rast është besuar se ka lindur zbatimi i drejtpërdrejtë i Kushtetutës, diçka që në kuadrin kushtetues kinez është e parealizueshme sepse nuk duron sistemi komunist supREmacinë e normës, portë e ideologjisë. Se kjo është kështu, u pa në vitin 2007, kur vetë **GJSRPK** tërhoqi interpretimin e saj nga rasti i sipërm i vitit 2001, duke e shpallur të njëjtin interpretim si të vdekur. Cf. më shumë për këtë në Guobin Zhu "Constitutional Review in China: An Unaccomplished Project or a Mirage?", fq. 644-649; Thomas E. Kellogg, Keith Hand, "NPCSC: The Vanguard of China's Constitution?" *China Brief* Volume 8 Issue: 2 (2008). Në internet: https://jamestoën.org/program/npcsc-the-vanguard-of-chinas-constitution/ (shikuar në gusht 2017); Për më shumë komente akademike të mëhershme, Cf. edhe Mo Jihong, "The Constitutional Law of the People's Republic of China and Its Development". *Columbia Journal of Asian Law* Vol. 23 No. 1 (Fall 2009) fq. 139-184 në fq. 173-181.

vendet perëndimore ku gjyqësori ka rol parësor në interpretimin e ligjeve dhe kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe të kushtetutshmërisë së veprimit të organeve të shtetit.

Ekzistojnë autorë që tregojnë se ka pasur një optimizëm në fillim të viteve '90 të shekullit të kaluar si dhe në fillim të këtij shekulli se **Kina** do të mund të hapë dyert e formalizimit të kontrollit kushtetues duke iu dhënë më shumë juridiksion kushtetues gjykatave kineze. Kjo në veçanti u duk se është e vërtetë pas viti 2001. Por, shumë shpejt këto shpresa u shuan dhe shteti partiak kinez iu rikthye origjinës së vet - sundimit të diktaturës popullore përmes **PKK**, pushtetit unik dhe të pandashëm, ku gjykatat i nënshtrohen organit më të lartë të pushtetit, Kongresit (si në nivel lokal ashtu dhe në nivel qendror). E tërë kjo duhet të jetë në funksion të ndërtimit të socializmit specifik kinez. E vetmja shpresë për vënien në jetë të dispozitave kushtetuese dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të natyrës kushtetuese, sic është vërejtur në literaturë, qëndron në përdorimin e mekanizmave alternativë të ndërmjetësimit. Këto njihen si "ndërmjetësimi i madh". Pse? Sepse në sistemin kinez të sundimit të **partisë shtet**, "judicializimi i mosmarrëveshjeve kushtetuese", përkatësisht vënia në jeta e Kushtetutës përmes gjykatave paraqet një sfidë të madhe për pushtetin e centralizuar të **PKK**.[149]

Sidoqoftë, vërehet se trendet bashkëkohore globale të zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese në botë kanë pasur ndikim në diskursin e estabilishmentit komunist kinez, i cili sikur ka zbutur kundërshtimin e një roli të kufizuar të gjyqësorit në vënien në jetë dhe interpretim të Kushtetutës, përfshirë këtu në veçanti vënien në jetë të dispozitave të saj lidhur me të drejtat dhe liritë njerëzore.[150] Kjo ka shumë rëndësi të vihet në spikamë, ani se do kohë të gjatë për t'u realizuar në praktikë ky diskurs i ri i zbutur kinez i ndikuar nga trendët globale të konstitucionalizmit bashkëkohor.[151]

Gjyqësia kushtetuese në **Tajvan** është e lidhur ngushtë me proceset politike të modernizimit të vendit, të nisura pas Luftës së Dytë Botërore, kryesisht gjatë viteve '60 të shekullit të kaluar. Krahas procesit të modernizimit, trashëgimia juridike koloniale ka luajtur po ashtu një rol në gjyqësinë kushtetuese të këtij vendi. Ky nuk është rasti me shtetin amë, **Kinën**, ku thuajse janë fshirë edhe shenjat e fundit të kësaj trashëgime koloniale.[152] Kjo trashëgimi koloniale dhe proceset e modernizimit janë reflektuar në secilën prej dispozitave kushtetuese të nxjerra pas vitit 1945. Një gjë e tillë është reflektuar edhe në fushën e gjyqësisë kushtetuese, rolit dhe pozitës së saj në këtë vend.

Një organ i veçantë i mandatuar për interpretim kushtetues është krijuar menjëherë me Kushtetutën e vitit 1946, e cila ka qenë e vlefshme për tërë territorin e Kinës. Ky organ përcaktohej me nenet 78 dhe 79.1 ["Gjyqësori"] të Kushtetutës, akoma në fuqi me amendamentet e shumta të mëpastajme,[153] dhe quhej **Këshilli i Gjyqtarëve**

---

149 Cf. më shumë për këtë dhe për ndërmjetësin si mënyrë të zgjidhje së mosmarrëveshjeve kushtetuese përmes përdorimit të argumentvee kushtetuese, si mënyrë alternative e vënies në jetë të dispozitave kushtetuese, në Keith Hand, "Resolving Constitutional Disputes in Contemporary China".*University of Pennsylvania East Asia Law Review Vol. 7 Issue 1* (2012) fq. 51-159.

150 Chris Thornhill, "The Sociological Origins of Global Constitutional Law". Në Alberto Febbrajo and Giancarlo Corsi (eds.), *Sociology of Constitutions. A Paradoxical Perspective* (Routledge: London and New York, 2016) fq.99-124 në fq. 104.

151 Disa autorë flasin për "judicializimin e kushtetutës kineze", që nga rasti i sipërcekur **Qi Yuling v. Chen Xiaoqi & Ors** i vitit 2001, me bindjen se ka një ndryshim në diskursin dhe mentalitetin kinez, si ndër pushtetarët ashtu dhe në mesin e popullsisë së thjeshtë, lidhur me fuqinë juridikisht të detyrueshme të Kushtetutës kineze. Megjithatë, kjo nuk është veçse një dëshirë nisur nga fakti se konceptualisht pushteti në Kinë qëndron në organet e partisë komuniste si avangardë dhe jo në organet e pushtetit shtetëror, të cilat formalisht dhe nominalisht paraqitetin në Kushtetutë si bartës të pushtetit. Cf. më shumë për "judicializimin e kushtetutës" dhe ndryshimin e diskursit dhe mentalitetit kinez, i cili tanimë gjoja e sheh Kushtetutën jo si një dokument politik, por si një dokument juridikisht të detyrueshëm dhe të zbatueshëm në rrugë gjyqësore nga gjykatat kineze, në punimin e Thomas E. Kellogg, "Constitutionalism with Chinese Characteristics?: Constitutional Development and Civil Litigation in China", 1-39.

152 **Tajvani** ka kaluar me cedim (bartje) nën sovranitetin japonez më 1895 si rezultat i luftës në mes të Japonisë dhe Kinës, në të cilën **Japonia** doli fitimtare. Gjatë kohës së kolonializmit japonez (1895 – 1945), në Tajvan u instalua sistemi juridik i Japonisë, i cili modelohej sipas standardeve evropiane, duke zëvendësuar në këtë mënyrë kodet dhe zakonet lokale kineze që kishn vlejtur ndër shekuj në këtë vend. **Tajvani** iu kthye **Kinës** në vitin 1945, pas humbjes së **Japonisë** në **Luftën e Dytë Botërore**. Cf. Wen – Chen Chang, "The Constitutional Court of Taivan". Në András Jakab, Arthur Dyevre and Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 641 – 677 në fq. 648-649.

153 *Constitution of Taiwan of 1946 with Amendments through 2005*. Në internet: http://www. parliament. am/library / sahmanadrutyunner/Taiwan.pdf (shikuar në korrik 2017).

të Mëdhenj (**KGJM**). Sipas neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës, **KGJM** funksionon si pjesë e **Gjyqësorit Yuan**, dhe paraqet instancën më të lartë të gjyqësorit në vend, ekuivalent me gjykatat supreme në vendet tjera.

KGJM në kompetencë të tij ka jo vetëm autorizimin për të interpretuar Kushtetutën, por edhe për të bërë një interpretim të unifikuar të ligjeve dhe rregullave të tjera. Nga ky formulim del se fjala është për një kontroll të koncentruar (centralizuar) të kushtetutshmërisë, përkatësisht se detyra e interpretimit të Kushtetutës është në mandat ekskluziv të organit më të lartë brenda **Gjyqësorit Yuan**. Vetëm ky organ, përkatësisht vetëm **KGJM** ka monopol ekskluziv për të interpretuar Kushtetutën. Si një digresion i vogël, vlen të theksohet me këtë rast se, në literaturë, gjyqësia kushtetuese tajvaneze konsiderohet më e vjetër se ajo e vendeve evropiane.[154] Vetë **KGJM**, ndërkaq, ka nisur punën në **Kinë** në vitin 1949, kurse pas këtij viti ka kaluar në **Tajvan** si pasojë e marrjes së pushtetit nga komunistët kinezë më 1 tetor 1949.

Në **Tajvan**, ku edhe sot e ka selinë, përgjatë historisë së zhvillimit të tij, gjyqësia kushtetuese e ushtruar nga **KGJM** ka kaluar nëpër dy faza: faza e parë është pas ikjes nga Kina si pasojë e ardhjes së komunistëve në pushtet. Në këtë fazë nacionalistët kinezë, të njohur si **Kuomintang**-ut (**Partia e Nacionalistëve të Kinës**), themeluan një regjim diktatorial njëpartiak. Ky regjim në Tajvan ka zgjatur deri në fund të viteve '80 të shekullit XX. Në këtë periudhë, **KGJM** ka shërbyer më shumë për të legjitimuar pushtetin njëpartiak të qeverisjes nacionaliste të **Kuomintang**-ut, sesa për ta kontrolluar atë.[155] Kjo gjendje ka ndryshuar në kuptim pozitiv në vitin 1987, kur sistemi njëpartiak u transformua në sistem demokratik shumëpartiak.[156] Ky transformim shënon fazën e dytë në zhvillimin e gjyqësisë kushtetuese tajvaneze. Kontrolli kushtetues në **Tajvan**, në fakt, ka kuptim vetëm pas këtij viti e tutje dhe, si i tillë, ai paraqitet si pjesë përbërëse e transformimit të përgjithshëm kushtetues dhe demokratik të shoqërisë.

Në Kushtetutë nuk ka asnjë dispozitë që përcakton hollësitë lidhur me organizimin dhe funksionimin e **KGJM**. Në fillim të punës, veprimtaria e tij është rregulluar me rregullat e brendshme të nxjerra nga vetë gjyqtarët e **Gjyqësorit Yuan**. Ato rregulla kanë shërbyer për të gjitha procedurat e juridiksionit të përgjithshëm, bazuar në një ligj organik që ka përcaktuar në vija të përgjithshme fizionominë e këtij institucioni.[157] Sa i përket juridiksioneve të tjera, siç është, ta zëmë, juridiksioni administrativ, kanë ekzistuar ligjet organike të veçanta që kanë vlejtur për fushën e veprimtarisë së juridiksioneve të tilla të veçanta.[158] Në këtë grup të ligjeve të veçanta hyn edhe ligji organik për **KGJM**.

Ai ligj organik për **KGJM**, megjithatë, është nxjerrë shumë më vonë se ligji organik më **Gjyqësorin Yuan**. Ka qenë viti 1958 në të cilin është nxjerrë ligji i parë organik që ka normuar organizimin dhe

---

154 Nuno Garoupa, Veronica Grembi and Shirley Ching-ping Lin, "Explaining Constitutional Review in New Democracies: The Case of Taiwan". *Pacific Rim Law & Policy Journal* Vol. 20 No. 1 (January 2011) fq. 1-40 në fq. 4-5. Lucia Dalla Pellegrina, Nuno Garoupa & Shirley Ching-ping Lin, "Judicial Ideal Points in New Democracies: The Case of Taiwan." *National Taiwan University Law Review* Vol. 7 No. 1 (2012) fq. 125-165 në fq. 125. Përveç kësaj, në këto dy shkrime të këtyre autorëve analizohen në mënyrë shkencore sjelljet e **KGJM** para vitit 1987 dhe pas këtij vitit kur edhe fillon transformimi i shoqërisë tajvanze nga sistemi njëpartiak në një sistem shumëpartiak dhe demokratik. Autorët e këtyre dy shkrimeve kanë vërejtur se në kohën para vitit 1987, Këshilli më shumë i ka shërbyer mbajtjes dhe legjitimimit të pushtetit njëpartiak, qasje e cila dukshëm ka ndryshuar pas këtij vitit, gjë që shihet në vendimmarrjen e **KGJM**, e cila është më e strukturuar dhe më shumë e orientuar kah sigurimi i supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës se sa kah sigurimi i supremacisë (epërsisë) së ndonjë ideologjie të caktuar.

155 Luca Fanotto, "La giustizia costituzionale negli ordinamenti asiatici (Corea del sud, Mongolia, Taiëan, Indonesia)". Në Luca Mezzetti (ed.), *Sistemi e modelli di giustizia costituzionale*, fq. 720.

156 Ibid. fq. 6.

157 **Ligji Organik mbi Gjyqësorin Yuan (1947) (Ligji i vitit 1947).** Në internet: http://www.judicial.gov.tw/ CONSTITUTIONALCOURT/p07_2.asp?lawno=81 (shikuar në korrik 2017);

158 **Ligji Organik për Gjykatën Administrative**. Në **internet:** http://jirs.judicial. gov. tw/ FLAW/ FLAW DAT 01 . asp?lsid=FL000090 (shikuar në korrik 2017).

procedurën e gjykimeve kushtetuese të **KGJM**. Më këtë ligj, në të njëjtën kohë, është përcaktuar emri aktual të këtij organi.[159] Ligji është amendamentuar në vitin 1993, në një mënyrë substanciale, duke e ndryshuar edhe emrin e vet. Ai sot quhet **Ligji Organik mbi Procedurën e Interpretimit të Kushtetutës** (Ligji i vitit 1993).[160] Pikërisht shkaku i këtij emërtimi, nga ky vit, **KGJM** nisi të quhet **Gjykata Kushtetuese e Tajvanit**.[161] Ky cilësim, megjithatë, i takon vetëm literaturës dhe jo realitetit: sipas definimit ligjor, fjala ka qenë dhe është për organin e njëjtë, për **KGJM**, i cili, si pjesë e **Gjyqësorit Yuan**, mblidhet sipas kërkesës së palëve të autorizuara ligjërisht për të ushtruar kompetencat në fushën e gjyqësisë kushtetuese të përcaktuara me Kushtetutë. Kjo është arsyeja pse edhe ne këtu i referohemi vetëm si **KGJM**, jo si gjykatë kushtetuese, gjithnjë me kuptim organin më të lartë në kuadër të gjyqësorit tajvanez, **Gjyqësorit Yuan**, me juridiksion të qartë të përcaktuar me Kushtetutë për të ushtruar kontrollin e kushtetutshmërisë në sensin si më sipër.

Sikundër u pa më lart, nenet 78 dhe 79.1 të Kushtetutës ia njohin **KGJM** të drejtën ekskluzive për interpretim të Kushtetutës, në ndërkohë që Ligji i vitit 1993 jep sqarim shtesë se përveç kësaj kompetence, ky organ ka edhe kompetencën e interpretimit unifikues të ligjeve. Nuk janë vetëm këto dispozita juridike që flasin për juridiksionin e KGJM me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës.[162] Në kapitullin e njëmbëdhjetë të Kushtetutës ekziston një nen, neni 114 ["Sistemi i Vetëqeverisjes Lokale"], që përcakton se, pas miratimit të akteve normative provinciale, të njëjtat duhet t'i paraqiten **Gjyqësorit Yuan** me qëllim të vlerësimit nëse ato janë në kundërshtim me Kushtetutën. Në një rast të tillë, dispozitat e akteve normative provinciale shpallen të pavlefshme dhe të paqena. Me **Gjyqësor Yuan**, rikujtojmë, nënkuptohet **GJKM** si pjesë përbërëse e tij me juridiksion të qartë dhe të ndarë në çështjet kushtetuese.

Nenet 171-173 ["Zbatimi dhe Amendamentimi i Kushtetutës"] të Kushtetutës më tutje përforcojnë juridiksionin e GJKM në sferën e kontrollit kushtetues të ligjeve dhe interpretimin e Kushtetutës. Paragrafi i parë i nenit 171 përcakton se legjislacioni që gjendet në kundërshtim me Kushtetutën konsiderohet i pavlefshëm dhe i paqenë, kurse i dyti saktëson se, në rast të dyshimit lidhur me kushtetutshmërinë, çështja zgjidhet përmes interpretimit të **Gjyqësorit Yuan.** Për aktet normative provinciale vlen rregulli i kontrollit të ligjshmërisë së tyre, jo vetëm i kushtetutshmërisë, pra ato duhet të jenë në pajtim edhe me ligjet qendrore. Kjo normohet me nenin 172 të Kushtetutës, i cili ka vetëm një paragraf. Në fund fare, neni 173 i Kushtetutës, i cili po ashtu ka vetëm një paragraf, rikonfirmon sërish se interpretimi kushtetues është prerogativë e **Gjyqësorit Yuan**. Të gjitha këto dispozita kushtetuese duhen shikuar në dritën e juridiksionit të përcaktuar me nenet 78 dhe 79.1 të Kushtetutës, të cilit juridiksion i kthehemi në vijim.

Nenet 78 dhe 79.1 të Kushtetutës janë nene të cilat përcaktojnë juridiksionin e **KGJM**. Këtë e sqaruam më sipër. Ky juridiksion më pastaj konfirmohet në seksionin 3 të Ligjit të vitit 1947, i cili është ligj sistemik

---

159 Ky ligj është quajtur **Ligji Organik mbi Këshillin e Drejtësisë së Madhe**. Cf. Wen – Chen Chang, "The Constitutional Court of Taivan", fq. 644.

160 Ky ligj është nxjerrë në bazë të nenit 6 të Ligji Organik mbi Gjyqësorin Yuan. Cf. *Constitutional Interpretation Procedure Act of 3 February 1993*. Në internet: http://www.judicial.gov.tw/constitutionalcourt/EN/p07_ 2 . asp?lawno=73 (shikuar në gusht 20178).

161 Neni 2 ["Formimi i Këshillit dhe Gjykatës Kushtetuese"] i Ligjit të vitit 1993: " Gjyqtarët e Gjyqësori Yuan (shkurt: "Gjyqësori") do të jenë në seanca en masse dhe do të gjykojnë peticionet lidhur me interpretimin e Kushtetutës dhe zbatimin uniform të ligjeve dhe rregulloreve; Gjyqtarët po ashtu mund të formojnë një gjykatë kushtetuese me qëllim që të shpallin shpërbërjen e një partie politike çdoherë kur ajo cenon Kushtetutën".

162 Në fakt, **Kushtetuta e Tajvanit** e vitit 1947 është Kushtetua e Republikës së Kinës (**Kina e Kuomintng**-ut). Kjo Kushtetutë është hartuar për të vlejtur për territorizn kinez, mirëpo më vonë në këtë vend erdhën komunistët dhe **Qeveria Nacionaliste e Kuomintang**-ut iku në **Tajvan,** ku sot e kësaj dite vepron, përkundër faktit se formalisht Tajvani i takon Kinës. **Republika Popullore e Kinës** është themeluar në vititn 1949, atë vit kur **Qeveria e Kumintang**-ut ka ikur në **Tajvan**. Cf. më shumë për hisotrinë kushtetuese të **Tajvan**-it në seksionin "Judicial Review in Taiwan: A Comparative Perspective" të Dennis T. C. Tang, "Judicial Review and Transition of Authoritarianism in Taiwan". A paper presented at *International Conference on the Transofrmation of an Authoritarian Regime: Taiwan in the Post-Marital Law Era* (Taiwan Studies Promotion Comitee, Taipei, Academia Sinica, April 1-3, 1999.

në krahasim me ligjin special që rregullon procedurën për interpretimin e Kushtetutës, pra në krahasim me Ligjin e vitit 1993. Ligji i vitit 1947, është ndryshuar substancialisht pas demokratizimit të vendit. Si i tillë, ai i zbërthen dy nenet e sipërcekura kushtetuese, duke u paraqitur në këtë mënyrë si ligj implementues i tyre, si dhe i neneve të tjera përkatëse që kanë të bëjnë me supremacinë (epërsinë) e Kushtetutës. Këtu fjala është, siç u tha më sipër, për Ligjin e vitit 1993, dispozitat e të cilit i shtjellojmë në vijim. Shënojmë se **KGJM** më 16 shtator 1948, i ka nxjerrë rregullat e brendshme, të njohura si **Rregullat e Këshillit të Gjyqtarëve të Mëdhenj (Rregullat e KGJM)**. T'i kthehemi tani shtjellimit të dispozitave të Ligjit të vitit 1993.

Në nenin 2 ["Formimi i Këshillit dhe i Gjykatës Kushtetuese"] të Ligjit të vitit 1993, përcaktohet detyra e të gjithë gjyqtarëve të **Gjyqësorit Yuan** për të bërë interpretimin e Kushtetutës si dhe interpretimin uniform të ligjeve dhe rregulloreve tjera. Kjo është fjalia e parë e paragrafit të vetëm të këtij neni. Në fjalinë e dytë të paragrafit të njëjtë përcaktohet mundësia e themelimit të një gjykate të veçantë kushtetuese për të shpallur shpërbërjen e një partie politike që vepron në kundërshtim me Kushtetutën. Kjo do të thotë se ky nen bën dallimin në mes të gjyqtarëve të **KGJM**, të cilët luajnë rolin e tyre të interpretuesit të Kushtetutës, dhe një trupi **ad hoc** që themelohet për të vepruar si gjykatë kushtetuese për qëllimin e sipërcekur (shpërbërjen e partive politike antikushtetuese). Neni në vijim i Ligjit të vitit 1993, përcakton se çka mund të jetë objekt i interpretimit kushtetues. Sipas formulimit të paragrafit të parë të këtij neni, **KGJM** bën interpretimin e Kushtetutës lidhur me çështjet si vijon:

- çështjet që kanë të bëjnë me dyshimet dhe dykuptimësitë me rastin e zbatimit të Kushtetutës;
- çështjet që kanë të bëjnë me kushtetutshmërinë e ligjeve apo rregulloreve; dhe
- çështjet që kanë të bëjnë me kushtetutshmërinë e ligjeve që rregullojnë vetëqeverisjen e provincave dhe komunave.

Nenet 5 ["Bazat për të Kërkuar Interpretimin"] dhe 6 ["Mbi Interpretimin e Rregullores për Vetëqeverisje"] të Ligjit të vitit 1993 sqarojnë modalitetet e interpretimit të cilin e kryen Këshilli me qëllim të vënies në jetë të tri interpretimeve si më sipër.

Në rend të parë, ky interpretim jepet për ato agjenci, të cilat kanë dyshime apo hamendje lidhur me ndonjë dispozitë kushtetuese, të cilën duhet ta zbatojnë, në rastet kur agjencitë kanë konflikt ndërmjet veti rreth dispozitave të caktuara kushtetuese, si dhe në ato raste kur të njëjta ngrehin pyetje lidhur me kushtetutshmërinë e ligjeve dhe rregulloreve, të cilat duhet t'i zbatojnë gjatë punës së tyre.

Interpretimi si më sipër, në rend të dytë, jepet edhe atëherë kur individët, personat juridikë apo partitë politike, të drejtat e të cilëve janë cenuar me një akt juridik në ndërkohë që i kanë shterur mjetet juridike për të adresuar cenimin e tillë të të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese, ngrehin pyetje lidhur me kushtetutshmërinë e ligjeve dhe rregulloreve, të cilat kanë shërbyer si bazë për vendimin përfundimtar që cenon të drejtat dhe liritë në fjalë.

Si rast tjetër kur jepet ky interpretim, paraqitet situata kur një e treta e ligjvënësve apo më shumë se kaq kanë dyshime lidhur me kuptimin e dispozitave të Kushtetutës që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrat e tyre, si dhe lidhur me kushtetutshmërinë e ligjeve, të cilat kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrat e tyre si ligjvënës.

Së katërti janë rastet kur **Gjykata Supreme** apo **Gjykata Supreme Administrative** kanë bindje të sinqertë se një dispozitë e caktuar ligjore apo e rregullores që duhet të zbatohet në një rast konkret para tyre gjendet në mospajtim me Kushtetutën. Në një rast të tillë, gjykata referuese e ndalon procedurën dhe pret vendimin e **KGJM** lidhur me kushtetutshmërinë.

Në fund fare, në nenin gjashtë të Ligjit të vitit 1993, i cili zbatohet në mënyrë analoge me nenin paraprak, përcaktohet procedura për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me vetëqeverisjen lokale. Lidhur me këtë lloje të kontrollit kushtetues, vlen të theksohet se neni 114 ["Sistemi i Vetëqeverisjes Lokale"] i Kushtetutës përcakton detyrën e **KGJM** për të vendosur në mënyrë automatike lidhur me kushtetutshmërinë e çdo rregullative mbi vetëqeverisjen lokale që nga moment i miratimit.

Nga kjo del se kontrolli i kushtetutshmërisë në **Tajvan** ka natyrë të **koncentruar** (**centralizuar**), mund të kryhet në mënyrë preventive, por edhe represive dhe, në fund, mund të ketë karakter **abstrakt** dhe konkret (**incidental**). Edhe spektri i palëve të autorizuara paraqitet si mjaft i gjerë ashtu që qasja në **KGJM** mund të jetë e drejtpërdrejtë (pa pasur nevojë të provohet ekzistimi i një interesi të veçantë juridiko – kushtetues për të iniciuar kontrollin e kushtetutshmërisë), por edhe e tërthortë apo **incidentale.**[163]

Japonia paraqet një rast jashtëzakonisht interesant, nisur nga fakti se zhvillimi kushtetues i këtij vendi ka rivalizuar kulturën perëndimore, me fillim që nga **Kushtetuta Meiji** (1889) deri në rrëzimin e sistemit diktatorial (1945), kur u nxor **Kushtetuta e Japonisë**, aktualisht në fuqi.[164] Kushtetuta e vitit 1889 i jepte Perandorit një pushtet absolut: i tërë pushteti legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor buronte nga Perandori.[165] Në literaturë ka pasur shkrime që kanë parë në regjimin politik imperial, të bazuar në këtë Kushtetutë (1889-1945), një lloj të demokracisë kushtetuese me premisa parlamentare.[166] Kjo, megjithatë, nuk mund të jetë e vërtetë sepse dispozitat e saj në mënyrë të qartë e bënin Perandorin burim të çdo pushteti në vend. Ajo qe modeluar sipas **Kushtetutës së Prusisë** të vitit 1850.[167] Si qëllim primar ka pasur adresimin e sfidave të modernitetit të shoqërisë japoneze dhe ndjekjen e trendëve zhvillimore të botës perëndimore. Sikundër krejt kushtetutat imperiale të kohës, ia ka njohur Perandorit pushtetin absolut, duke e cilësuar atë si burimi të krejt pushtetit shtetëror dhe si forcën lëvizëse të progresit social e shtetëror[168].

Në këtë periudhë as që mund të flitet për ndarje të pushteteve apo për ndonjë rol të gjyqësorit në kontrollin dhe balansimin e pushtetit shtetëror. Kjo u bë e mundur vetëm pas mbarimit të **Luftës së Dytë Botërore** dhe kolapsit total të regjimit perandorak japonez dhe imponimit me forcë, në vitit 1946, të **Kushtetutës së Japonisë**, e cila hyri në fuqi një vit më vonë. Kushtetuta shpesh quhet edhe si **Kushtetuta MacArtur**, sipas emrit të komandantit të forcave okupuese aleate pas **Luftës së Dytë Botërore**, gjeneralit amerikan **Dagllas Mek Artur** (Dauglas MacArthur:1880-1964).

Kushtetuta e vitit 1946, ka përmbysur në tërësi konceptin perandorak të kushtetutës pararendëse, në secilin aspekt të saj. Perandori tani paraqitet jo më si burim pushteti, por si simbol i Shtetit dhe i unitetit të popullit. Pozita e tij derivohet nga vullneti i popullit, të cilit i takon sovraniteti në mënyrë ekskluzive.[169] Përveç kësaj, Perandori më nuk është i veshur me pushtet ekzekutiv: ai pushtet tani i takon Qeverisë, buron në tërësi nga Kushtetuta dhe ushtrohet në bazë të saj dhe ligjeve nacionale. Si ligjvënës i vetëm në vend është Parlamenti.[170] Qeveria i përgjigjet Parlamentit, që do të thotë se bëhet fjalë për një demokraci kushtetuese parlamentare[171].

Gjyqësori japonez tanimë nuk bën pjesë në ekzekutiv të vendit, sic ishte në Kushtetutën e vitit 1899. Ai paraqet një degë të pavarur të pushtetit. Kushtetuta këtij pushteti ia dedikon nenet 76-82 të kapitullit VI.

---

163 Për juridiksionin e **KGJM**, cf. më shumë në Wen – Chen Chang, "The Constitutional Court of Taivan", fq. 644-647.

164 *Constitution of Japan of 1946*. Në internet: https://www. constituteproject. org/ constitution /Japan_ 1946. pdf? lang=en (shikuar në korrik 2017).

165 Cf. për dispozitat e caltuara të kësaj kushtetue në: *EXCERPTS FROM THE MEIJI CONSTITUTION OF 1889*. Primary Source Document with Questions (DBQs). Në internet: http://afe.easia.columbia.edu/ps/japan/ meiji_constitution.pdf (shikuar në korrik 2017).

166 Masuda Tomo (translated by A. Fraser), "The Meiji Constitution: Theory and Practice". *East Asian History* Vol. 1 (June 1991) fq. 125 – 140.

167 Luca Fanotto, "La giustizia costituzionale in Giappone." Në Luca Mezzetti (ed.), *Sistemi e modelli di giustizia costituzionale*, fq. 505-538 në fq. 505.

168 John M. Maki, *Government and Politics in Japan. A Road to Democracy* (Frederick A. Praeger: New York, 1962) fq. 18-20; Csaba Gergely Tamás, "The Birth of the Parliamentary Democracy in Japan: An Historical Approach." *Zeitschrift für Japanisches Recht / Journal of Japanese Law* Vol. 17 (Spring) No. 33 fq. 146-167 në. 146-150.

169 Neni 1 ["Kapitulli I.: Perandori"] i Kushtetutës.

170 Cf. Nenet: 4 ["Kapitulli I.: Perandori"] lidhur me nenin 65 ["Kapitulli V.: Kabineti"] të Kushtetutës.

171 Cf. Nenin 41 ["Kapitulli IV.: Diet-i"] i Kushtetutës.

Si i tillë, ky pushtet gjendet në duart e një gjykate supreme dhe gjykatave të tjera më të ulëta, të cilat mund të themelohen me ligj, dhe ushtrohet ekskluzivisht në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.[172]

Nga këto dispozita kushtetuese, akoma nuk mund të shihet qartë se cili është modeli japonez i kontrollit kushtetues. Ai model nuk duket as nga redaktimi i dispozitës së nenit 81 të Kushtetutës, i cili thotë se **Gjykata Supreme e Japonisë** (**GJSJa**) "[...] është gjykatë e shkallës së fundit me autoritet të plotë për të përcaktuar kushtetutshmërinë e çdo ligji, urdhri, rregulloreje apo akti zyrtar".

Nuk ndihmon shumë në qartësim të modelit të gjyqësisë kushtetuese në këtë vend as redaktimi i nenit 98 të Kushtetutës ["Kapitulli X.: Ligji Suprem"]. Ky nen përcakton se, **inter alia** "[...] Kushtetuta do të jetë ligj suprem i vendit dhe çdo ligj, urdhër, vendim perandorak apo akt qeveritar, si dhe ndonjë pjesë e tyre që bie ndesh me të do të jetë i pavlefshëm dhe nuk mund të ketë fuqi juridike". Nuk ka asnjë shenjë në këto dispozita se kush është gardian i Kushtetutës dhe cili është mekanizimi për ruajtjen e supremacisë (epërsisë) së saj që proklamohet në rreshtat e sipërcekur të nenit 98.

Kjo çështje ka qenë objekt diskutimi në literaturë për një kohë të gjatë, pra, çështja se në cilin model të gjyqësisë kushtetuese bën pjesë **Japonia**. Këtë nuk e ka zgjidhur doktrina, por praktika gjyqësore: **GJSJa**, në mënyrë të qartë ka dhënë përgjigjen në lidhje me modelin e gjyqësisë kushtetuese japoneze me vendimin e saj të njohur si **Komatsu v Japan** (1948). Me këtë vendim, kjo gjykatë e radhiti gjyqësinë kushtetuese japoneze në radhën e vendeve me sistemin amerikan, qëndrim të cilin më vonë e ka forcuar dhe konfirmuar me rastin **Tomabechi v. Japan** (1953).[173] Në këto dy raste, **GJSJa** ka konstatuar se nuk mund të ketë kontroll abstrakt të kushtetutshmërisë, por vetëm kontroll të natyrës së tërthortë (**incidentale**), pra, kontroll kushtetues që është pjesë e pandashme e zgjidhjes apo vendosjes për një rast apo mosmarrëveshje konkrete dhe reale.

Në përgjithësi, **GJSJa**, deri më sot, ka ruajtur këtë linjë të kontrollit të kushtetutshmërisë, duke përdorur teknika dhe vendimmarrje të atilla që ikin nga kontrolli abstrakt i kushtetutshmërisë. Kjo është bërë për të respektuar normën e cekur më sipër kushtetuese, që ia njeh në mënyrë shprehimore supremacinë (epërsinë) **Parlamentit të Japonisë** (**Diet)**. Edhe interpretimet e Kushtetutës çdoherë kanë pasur parasysh këtë postulat dhe kanë gjykuar në favor të prezumimit të kushtetutshmërisë së veprimeve të organit legjislativ.

Që nga themelimi, konform Kushtetutës së vitit 1947, **GJSJa** ka shfuqizuar vetëm tetë ligje, duke përdorur gjuhë e teknika jashtëzakonisht restriktive të kontrollit kushtetues me qëllim të ruajtjes së autoritetit të përfaqësuesit të sovranit japonez, **Diet**-it.[174] Në literaturë janë dhënë disa arsye për këtë qasje: e para, thuhet se kontrolli i ekzekutivit japonez në përzgjedhjen e gjyqtarëve dhe kryetarit të **GJSJa** ka qenë dhe akoma është i madh; e dyta, thuhet se një organ i ngjashëm me **Këshillin Kushtetues të Francës**, i njohur si **Byroja për Legjislacion e Kabinetit** ("Cabinet Legislation Bureau"), ka luajtur rolin e kontrolluesit preventiv të kushtetutshmërisë, për shkak se shumica e aktivitetit legjislativ buron nga ekzekutivi; dhe, së fundi, e treta, fakti se Kushtetuta asnjëherë nuk është ndryshuar që nga miratimi i saj në vitin 1946. Këto rrethana, të marra së bashku, kanë kontribuar në mbajtjen e një qëndrimi konservativ nga ana **GJSJa**. Kjo nuk ndryshon asgjë nëse konstatojmë se ajo shumë herë ka marrë anën e mbrojtësit të lirive dhe të drejtave të japonezëve.[175]

Nga kjo shihet se **Japonia** ka një sistem dhe fizionomi të caktuar dhe të qartë të kontrollit kushtetues që i përket proveniencës perëndimore, si në formë ashtu dhe në përmbajtje. Në fillim ka pasur debate për

[172] Neni 76. 2 & 3 ["Kapitulli VI.: Gjyqësori"] i Kushtetutës.

[173] Për këtë vendim dhe analizën e debateve në lidhje me vendin e gjyqësisë kushtetuese japoneze, cf. më shumë në Luca Fanotto, "La giustizia costituzionale in Giappone", fq. 510-511.

[174] Shojiro Sakaguchi, "Major constitutional Developments in Japan in teh first decade of the tWenty –first century". Albert H. Y. Chen, *Constitutionalism in Asia in the Early Tëenty – First Century* (Cambridge University Press: Cambridge, 2014) fq. 52-75 në fq. 53, 67, 70, 73, 75.

[175] Ibid. fq. 67-72.

këtë, jo sa i përket përmbajtjes por formës: që nga fillimi ka qenë e qartë se kontrolli i kushtetutshmërisë japoneze në përmbajtje i përket proveniencës perëndimore liberale, ashtu siç i përket Kushtetuta (ani se është imponuar nga forcat okupuese aleate pas mbarimit të **Luftë së Dytë Botërore**).[176] Debati i sipërcekur ka pasur të bëjë kryesisht me formën ku përfshihen modeli, lloji i dizajnit kushtetues dhe mekanizmi i përcaktuar kushtetutës për kryerjen e kontrollit të kushtetutës me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës.

Ka qenë vetë **GJSJa** ajo që ka saktësuar se modeli i kontrollit kushtetues nuk është i centralizuar, siç mund të kuptohet edhe nga dispozita e nenit 81 të Kushtetutës. Ai kontroll ushtrohet nga çdo gjykatës japonez. Kjo është konstatuar edhe me vendimin e **GJSJa** në rastin **Yango v Japan** (1950). Kjo nënkupton se, në parim, **Japonia** si një vend që i takon sistemit të së drejtës civile (kontinentale), nuk ka një doktrinë **stare decisis** me të cilën do të mund të sigurohej efekti uniform me kuptim të përdorimit të vendimeve të **GJSJa** si precedentë për të ardhmen. Kjo, megjithatë, nuk është kështu: kur **GJSJa** vendos sipas ankesës, vendimet e saj domosdoshmërisht kanë efekt të përgjithshëm detyrues (**erga omnes)**, pa marrë parasysh që ligji apo norma e shpallur si jo kushtetuese, në aspektin formal, mund të ngelet në fuqi edhe më tutje. Me një fjalë, **funksioni nomofilaktik** i gjykatës më të lartë në vend ekziston i palëkundur edhe në rastin japonez.

Në çështjet kushtetuese, siç u tha më herët, vendimet e **GJSJa** kufizohen vetëm në çështjet që kanë të bëjnë me cenimin apo interpretimin e gabuar të Kushtetutës, me vendimet e saj kundërthënëse nga e kaluara apo me vendimet kundërthënëse të shqiptuara nga gjyqtarët tjerë brenda kësaj gjykate. Në këto raste, **GJSJa** e ka fjalën e fundit dhe kjo bëhet, siç u pa, me qëllim të sigurimit dhe ruajtjes së **funksionit nomofilaktik** të garantuar me Kushtetutë. Në këtë kuptim duhet parë dispozitën e nenit 81 të Kushtetutës, pra jo si një dispozitë që përjashton gjyqësorin e ulët për të ushtuar kontrollin e kushtetutshmërisë gjatë zgjidhjes apo vendosjes së rasteve dhe mosmarrëveshjeve konkrete.

Ky **kontroll difuz** (i decentralizuar) mundëson në të njëjtën kohë edhe sigurimin e supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës përmes ushtrimit nga ana e **GJSJa** të rolit të saj unifikues në çështjet që janë nën juridiksionin e saj sipas mjeteve juridike në instancë të fundit. Me fjalë të tjera, sikundër në rastet tjera të vendeve që modelohen sipas sistemit amerikan, **GJSJa** vetë nuk bën mos aplikimin e ligjeve si pasojë e jo kushtetutshmërisë së tyre, sepse kjo e drejtë ushtrohet nga nivelet e ulëta të gjyqësorit, por kujdeset për interpretimin e Kushtetutës me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së saj në të gjitha procedurat gjyqësore që zhvillohen pranë saj sipas mjeteve të goditjes në shkallë të fundit apo gjatë ushtrimit të juridiksionit të saj origjinal (në shkallë të parë dhe të fundit).

Vetëm në një rast ka ndodhur mos aplikimi i ligjit si jo kushtetues nga ana e saj: në rastin **Aizawa v Japan** (1973). Kjo për shkak se, siç u tha, **GJSJa** kujdeset në shkallë të fundit për vënien në jetë të dispozitës së nenit 81 të Kushtetutës, në rastet kur një gjë e tillë nuk është bërë nga ana e gjykatave më të ulëta. Kjo mbikëqyrje nuk bëhet duke mënjanuar nga faqja e dheut ligjin

---

[176] Të gjitha përpjekjet për ndryshim të **Kushtetutës së Japonisë** në vitet ’60 dhe ’70 të shekullit të kaluar, por edhe ato të fillimit të shekullit XXI, kanë pasur të bëjnë me ndryshimin e dispozitave që kanë të bëjnë me sigurinë, ushtrinë, sovranitetin dhe përdorimin e forcës ushtarake të këtij vendi, si në vend ashtu dhe në botën e jashtme. Kjo sepse nëni 9 i Kushtetutës [“Heqja Dorë nga Lufta”], i cili është nen i vetëm në kapitullin e dytë dhe ka vetëm dy paragrafë, paraqet një pengesë serioze në këtë drejtim meqë në mënyrë të qartë përcakton ndalimin e **Japonisë** për të poseduar çfarëdo armate dhe çfarëdo armatimi apo strukturimi që ka tiparet e armatës japoneze si një shtet sovran dhe i pavarur. Në paragrafin e parë të nenit 9 si më sipër, japonezët heqin dorë përgjithmonë nga lufta apo kërcënimi me forcë, si një e drejtë sovrane që i takon çdo kombi sovran dhe të pavarur. Paragrafi i dytë shkon më tutje se kaq, Japonia heq dorë, sipas këtij paragrafi, nga ndërtimi i kapacitetit luftarak në tokë, det dhe në ajër dhe nga çdo e drejtë për të luftuar.
Ka pasur raste, megjithatë, kur këto ndryshime kanë synuar që të fusin në **Kushtetutën e Japonisë** të dispozitave që kanë të bëjnë me respektimin e specifikave aziatike dhe lokale të këtij vendi, më veçanti sa i përket individit, përkatësisht duke mohuar të drejtat individuale të japonezëve dhe duke u fokusuar në anën kolektive të shpirtit japonez. Cf. më shumë për të gjitha këto si më sipër në: Ibid. fq. 65-66.

jo kushtetues, por duke ia mohuar atij vlefshmërinë juridike për rastet e më pastajme sepse ka pasur gabime në interpretim të Kushtetutës, për shkak se Kushtetuta është shkelur gjatë interpretimit të bërë nga gjykatat e ulëta, dhe, së fundi, si rrjedhojë e vendimeve kundërthënëse në të kaluarën të vetë **GJSJa** apo ndonjërit prej gjyqtarëve të saj.[177]

8.9. Afrika: Afrika e Jugut dhe vendet tjera afrikane

Afrika e Jugut përbën ndër rastet më të suksesshme të gjyqësisë kushtetuese në botën bashkëkohore. Ky sukses i dedikohet punës së palodhshme dhe profesionale të **Gjykatës Kushtetuese të Afrikës së Jugut (GJKAJ)**, e themeluar mbi bazën e një dokumenti të titulluar si "Autoriteti Gjyqësor dhe Administrimi i Gjyqësisë", i cili, më pastaj, me të njëjtin emër, u shndërrua në Kapitullin VII të **Kushtetutës së Përkohshme të Afrikës së Jugut** të vitit 1993. Nenet 97-100 të këtij kapitulli bënin fjalë për Gjykata Kushtetuese, fizionominë, mënyrën e formimit, funksionet dhe palët e autorizuara për tu paraqitur pranë saj.[178]

GJKAJ ka nisur punën dy vjet më vonë, në shkurt të vitit 1995, ende pa u miratuar teksti i kushtetutës së përhershme të këtij vendi, **Kushtetutës së Afrikës së Jugut** të vitit 1996, aktualisht në fuqi.[179] Që nga ajo kohë, ajo ka qenë pjesë e dispozitave kushtetuese mbi gjyqësorin afrikano-jugor. E tillë figuron edhe sot, pra si pjesë e gjyqësorit të këtij vendi.[180] Për nga natyra, megjithatë, **GJKAJ** bën pjesë në sistemin e gjyqësisë së centralizuar (koncentruar) të kontrollit të kushtetutshmërisë, ani se fjala është për një vend që i përket sistemit të së **drejtës së përgjithshme**.

Neni 165.1 i Kushtetutës së vitit 1996, përcakton se autoriteti gjyqësor në **Republikën e Afrikës së Jugut** ushtrohet nga gjykatat, të cilat janë të pavarura dhe që i nënshtrohen vetëm asaj dhe ligjeve nacionale, duke i zbatuar ato në mënyrë të paanshme, pa asnjë frikë, favor apo paragjykim. Në dispozitat e saj, ajo përcakton strukturën e gjyqësorit afrikano-jugor, sipas rangut që secila gjykatë e ka në hierarkinë e tërësishme të tij. Ky përcaktim gjendet në dispozitat e nenit të saj 166 (pikat "a - e") dhe duket kështu:

a. Gjykata Kushtetuese;
b. Gjykata Supreme;
c. Gjykata e Lartë, përfshirë Gjykatën e Lartë të Apelit që mund të krijohet me një ligj të Parlamentit për të vendosur lidhur me ankesat kundër vendimeve të gjykatave të larta;
d. Gjykata e Shkallë së Parë; dhe
e. Çdo gjykatë tjetër që themelohet apo pranohet nga ligji i Parlamentit, si p.sh. gjykatat për kërkesat e vogla, përfshirë çdo gjykatë tjetër me status të ngjashëm me Gjykatën e Lartë apo Gjykatën e Shkallës së Parë.

---

177 Ibid. fq. 525-534.

178 *Constitution of the Republic of South Africa Act 200 of 1993*. *Repealed by the Constitution of the Republic of South Africa, [No. 108 of 1996], G 17678, 18 December 1996*. Në Internet: https://www.gov. za/ documents / constitution/constitution-republic-south-africa-act-200-1993 (shikuar në gusht 2017).

179 Kjo rrethanë në literaturë merret si paradoks sepse kuvendi kushtetutdhënës i Afrikës ë Jugut akoma pa krijuar organet kushtetuese me autorizime për të kontrolluar kushtetutshmërinë në nivel nacional, pra akoma pa krijuar një gjykatë kushtetuese, ka lejuar që të nis punën një organ me juridiksion të ndarë të kontrollit të koncentruar (centralizuar) të kushtetutshmërisë. Kjo është pasojë e specifikave të këtij vendi dhe e konsensusit nacional lidhur me padrejtësitë e bëra ndaj njerëzve me ngjyrë në Afrikën e Jugut nga ana e të sunduesve evropian përgjatë dekadave të tëra dhe nevojën për eliminimin e kësaj padrejtësie historike. Cf. Andrea Lollini, "La Corte costituzionale sudafricana". Në Luca Mezzetti (ed.), *Sistemi e modelli di giustizia costituzionale*, fq. 785-815 në fq. 785-786.

180 Nenet: 165 ["Autoriteti Gjyqësor"], 166 ["Sistemi Gjyqësor"] dhe 167 ["Gjykata Kushtetuese"] të Kushtetutës. Cf. *The Constitution of the Republic of South Africa of 1996. As adopted on 8 May 1996 and amended on 11 October 1996 by the Constitutional Assembly*. Në internet: http://www. justice. gov. za/ legislation / constitution/ SA Constitution-web-eng.pdf (shikuar në gusht 2017).

GJKAJ është gjykatë e specializuar dhe gjykata më e lartë në vend në lidhje me çështjet kushtetuese. Para themelimit, në këtë vend ka pasur një debat të gjerë dhe të gjatë lidhur me mundësinë e koekzistimit të saj me sistemin e gjyqësisë së vjetër. Kjo për shkak të faktit se regjimi brutal i **aparteheid-it** nga koha e kaluar ka kompromet uar gjyqësorin e rregullt. Shih për këtë, në fund u ra dakord që rruga më e mirë për t'u zgjedhur është themelimi i një gjykate të specializuar me qëllim të vënies në jetë të dispozitave të reja kushtetuese lidhur me supremacinë (epërsinë) e Kushtetutës dhe kulturës së të drejtave të njeriut që po konsolidohej pas rënies së regjimit të vjetër. U konstatua me shumë të drejtë se funksioni i gjyqësisë kushtetuese përbën një funksion fundamental dhe tepër të rëndësishëm për t'iu lënë në dorë gjyqësisë së vjetër, të përbërë nga gjyqtarë të kompromet uar të kohës së **apartheidit: Gjykata Supreme e Afrikës së Jugut** (**GJSAJ**) kishte një rekord të varfër në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, një situatë e ngjashme me të gjitha vendet tjera që kishin kaluar nëpër regjime diktatoriale dhe diskriminuese. Vendet e tilla janë vendet e Evropës pas rënies së komunizmit, **Spanja**, **Portuglia** e **Greqia** në mesin e viteve '70 të shekullit të kaluar, **Austria**, **Italia** e **Gjermania** pas **Luftës së Dytë Botërore** dhe kështu me radhë. Me fjalë të tjera, në rastin e **Afrikës së Jugut**, njëjtë si në rastet më sipër, gjyqësorit të vjetër i ka munguar legjitimiteti për t'u dhënë rrugë dhe shprehje adekuate dispozitave të reja kushtetuese, në pajtim me karakterin dhe etosin që duhej ndërtuar mbi bazën e këtyre dispozitave të reja kushtetuese.

Vetëm një nen i Kushtetutës së vitit 1996, neni 167, normon juridiksionin e **GJKAJ**, përcakton fizionominë dhe mënyrën e vendimmarrjes së saj.[181] Ky nen e bën atë të dallueshme kundrejt pjesëve të tjera të gjyqësorit të këtij vendi. Në pikën e tretë të këtij neni, në një mënyrë të saktë definohet juridiksioni i saj. Paragrafi i parë i tij, ndërkaq, e definon atë si gjykatën më të lartë në vend, kurse tjetri në vijim flet për caqet e vendimmarrjes së saj.

Sipas paragrafit të tretë të nenit 167 të Kushtetutës, **GJKAJ** mund të vendos për:

(i) çështjet kushtetuese;

(ii) çdo çështje tjetër, e cila, sipas lejes së Gjykatës, mund të cilësohet si çështje me rëndësi të madhe juridike për publikun; dhe

(iii) në mënyrë autoritative, vendos nëse një çështje bie në kuadër të juridiksionit të saj.

Këto janë përcaktimet bazë lidhur fizionominë, përkatësisht përcaktimet me të cilat definohet roli dhe pozita e kësaj gjykate në sistemin e përgjithshëm të drejtësisë në vend. Në paragrafin e katërt të nenit 167, Kushtetuta përcakton juridiksionin përjashtues të Gjykatës. Ky juridiksion përjashtues është taksativisht i numëruar dhe në mënyrë konkrete. Si i tillë, ai ka për qëllim që të eliminojë çdo dyshim se kompetencat e numëruara aty nuk mund t'i takojnë asnjë gjykate tjetër. Për këtë qëllim, dispozita e këtij paragrafi është skajshmërisht përjashtuese duke treguar se çfarë mund të vendoset ekskluzivisht nga **GJKAJ** duke përjashtuar çdo gjykate tjetër në vend. Vetëm ajo mund të vendosë, thuhet në paragrafin e katërt, për sa vijon:

a. konfliktet për kompetencë në mes të organeve të shtetit në nivel nacional dhe provincional, të cilat kanë të bëjnë me statusin kushtetues, autorizimet dhe pushtetet e secilit organ shtetëror;

b. kushtetutshmërinë e çdo ligji nacional apo provincial, por vetëm nën kushtet e përcaktuara me nenin 79 apo 121,[182]

c. kërkesat e parashikuara nga neni 80 apo 122,[183]

---

[181] Për të vendosur meritorisht një çështje kërkohet vota e tetë (8) gjyqtarëve nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë sa ka i ka **GJKAJ**, thuhet në nenin 167. 2 të Kushtetutës.

[182] Këto dy nene rregullojnë çështjen e presidentit afrikano-jugor dhe kryeministrit në nivel provincial për dhënien e pëlqimit për draftligjin e miratuar nga parlamenti nacional përkatësisht provincial ose të kundërtën për dërgimin e tij në GJKAJ në rast të dyshimit lidhur me kushtetutshmërinë e tij.

[183] Këto dy nene rregullojnë çështjen e aplikimit në GJKAJ të anëtarëve të parlamentit nacional apo të anëtarëve të parlamentit provincial lidhur me kushtetutshmërinë e një akti të nxjerrë nga parlamenti nacional përkatësisht provincial.

d. kushtetutshmërinë e çdo amendamenti në Kushtetutë;
e. përcaktimin nëse Parlamenti apo Presidenti kanë dështuar për të përmbushur detyrimin e tyre kushtetues; dhe
f. certifikimin e kushtetutës provinciale në kuptim të nenit 144.[184]

Paragrafi i pestë në vijim flet për juridiksionin apelues të kësaj gjykate. Nga ky paragraf shihet qartë se në **Afrikën e Jugut** ekziston një sistem i përzier, ku **GJKAJ** e ka fjalën e fundit lidhur me çështjet e kushtetutshmërisë. Mirëpo, krahas saj, gjyqësori i nivelit më lartë ka të drejtën e shpalljes së pavlefshme të ndonjë ligji apo të dispozitave të tij, gjithnjë me rezervë se fjalën përfundimtare për këtë duhet ta këtë **GJKAJ**. Në këtë kuadër, Kushtetuta thekson se Gjykata vendos:

- nëse një ligj i Parlamentit, i Provincës apo ndonjë sjellje e Presidentit janë kushtetues; dhe
- lidhur me konfirmimin e çdo vendimi mbi pavlefshmërinë e një ligji apo dispozite tjetër juridike të shqiptuar nga Gjykata Supreme, Gjykata e Lartë e Apelit apo ndonjë gjykatë e statusit të njëjtë, para se ai vendim të ketë marrë formën e prerë.

Paragrafi i gjashtë i nenit si më sipër të Kushtetutës flet për individin si palë e autorizuar që ka të drejtë për të ngritur në mënyrë të drejtpërdrejtë në **GJKAJ**:

a. çdo çështjeje kushtetuese; dhe
b. ankesë kundër çdo gjykate tjetër.

Kjo e drejtë e individit si më sipër mund të bëhet vetëm me leje paraprake të GJKAJ dhe në rastet kur një gjë e tillë është në interes të drejtësisë dhe e përcaktuar më një ligj nacional apo me rregulloret e saj të brendshme të Gjykatës Kushtetuese.[185]

Paragrafi i fundit, i shtati me radhë, definon se çka nënkuptohet me çështje kushtetuese, e cila mund të ngrihet nga individët me leje të veçantë të **GJKAJ**. Sipas këtij paragrafi, me çështje kushtetuese nënkuptohet çdo çështje që ka të bëjë me interpretimin, mbrojtjen dhe zbatimin e Kushtetutës.

Me **vende të tjera afrikane** mendohet në vendet frankofone të **Afrikës**, pa vendet e **Magrebit**, për të cilat kemi folur më herët. Nuk përfshihet as **Afrika e Jugut**, për të cilën po ashtu folëm më sipër si për një shembull të gjyqësisë së mirëfilltë kushtetuese, ani se në tranzicion dhe me një sistem juridik të së **drejtës së përgjithshme.**

Vendet frankofone të **Afrikës**, të cilat diskutohen në vijim, kanë një strukturë të përzier të gjyqësisë kushtetuese, që buron nga ndikimet e jashtme të ndryshme, por edhe nga ndikimi i përvojave dhe traditave lokale. Do të ishte e pritshme dhe krejt e natyrshme, në shikim të parë, që modeli francez të ketë pasur ndikim të madh në modelin e gjyqësisë kushtetuese të këtyre vendeve që nga fitimi i pavarësisë së tyre nga **Franca** (procesi i dekolonizimit i filluar nga mesi i shekullit '20-të). Kështu ka ndodhur me vendet **anglofone** të këtij kontinenti, të cilat kanë ndjekur rrugën e **Britanisë së Madhe** në sferën e konstitucionalizmit në përgjithësi. Ky, megjithatë, nuk ka qenë rasti me vendet **frankofone** të **Afrikës**, të cilat kanë pasur një zhvillim të çuditshëm.

Në fillim, pas dekolonizimit të tyre, sistemi gjyqësor nuk ka qenë i modeluar sipas **sistemit francez**. Në këtë sistem, sikundër dihet, ekzistojnë disa juridiksione: juridiksioni administrativ në krye me Këshillin e Shtetit (***Conseil d'État),*** *juridiksioni i rregullt, në krye me Gjykatën e Kasacionit si gjykatë supreme (**Cour de Cassation***), krahas juridiksioneve speciale në lëmin kushtetues, të ushtruar nga Këshilli Kushtetuese (***Conseil***

[184] Neni 144 flet për procedurën e certifikimit të kushtetutave provinciale me qëllim që ato të jenë në pajtim me Kushtetutën, vlerat dhe parimet mbi të cilat ndërtohet shoqëria e sotme në këtë vend, pa asnjë diskriminim dhe në barazi të plotë të të gjithëve, me një qeverisje kooperative në nivel horizontal dhe vertikal.

[185] *Constitutional Court Complementary Act 13 of 1995*. http://www.justice.gov.za/legislation/acts/1995-013.pdf (shikuar në gusht 2017); *Rules of the Court. Promulgated under the Government Notice R1675 in Government Gazette 25726 of 31 October 2003*. Në internet:http://www.constitutionalcourt.org.za/site/thecourt/rulesofthecourt.htm (shikuar në gusht 2017).

Constitutionnel) dhe **në lëmin e financave publike, të ushtruar nga Gjykata e Auditimit (*Cour des Comptes).*** *K*onfliktet për kompetencë në mes të këtyre juridiksioneve të ndara në **Francë** zgjidhen nga **Tribunal des Conflict**, jo nga ***Conseil Constitutionnel,*** *siç ndodhë gjetiu ku konfliktet për kompetencë i zgjedh gjykata apo këshilli kushtetues, apo ndonjë organ tjetër i barasvlefshëm më to.*[186]

Në vendet **frankofone**, megjithatë, nuk u përqafua sistemi francez si më sipër. Deri në mbarimin e Luftës së Ftoht, këto vendet ruajtën sistemin unik të gjyqësisë së rregullt, me gjykatën supreme në krye të sistemit gjyqësor. Ruajtja e sistemit unik gjyqësor, në literaturë është arsyetuar me nevojën këto vende kanë pasur për të krijuar kohezivitet nacional. Si vende të reja të dala nga kolonializmi, vendet frankofone kanë hasur në vështirësi të mëdha në rrugën e tyre për krijimin e kohezivitetit social, krejt kjo si pasojë e lëvizjeve të brendshme separatiste, mungesës së identitetit të konsoliduar nacional, moszhvillimit ekonomik, si dhe funksionimit të një dyzine rendesh juridike autoktone dhe fetare nëpër këto vende.[187] Nevoja për kohezivitet social ka prodhuar regjime diktatoriale, të cilat, përmes politikave represive nga lart poshtë, kanë provuar farkëtimin e këtij koheziviteti. Kjo nevojë duket të këtë vlejtur për tërë kontinentin afrikan pas dekolonizimit e deri në mbarimin e **Luftës së Ftohtë**.[188] Në fakt, kushtet e **bipolaritetit** në marrëdhëniet ndërkombëtare të kësaj kohe kanë qenë përcaktuesi kryesor në krijimin e ambienteve të brendshme juridike, shumë miqësore ndaj regjimeve diktatoriale, ku kujdesi për individin dhe sigurinë e tij si mënyrë për prodhim të kohezivitetit social ka qenë zero. Si pikë kthese për ndërprerjen e kësaj praktike të ndërtimit të kohezivitetit social përmes qeverisjeve autoritare merret një konferencë, mbajtur në **Benin** më 19-20 shkurt 1990.[189] Në literaturë, kjo ngjarje krahasohet me rënien e **Murit të Berlinit** në Evropë: nga kjo kohë, vendet frankofone të **Afrikës** rizbuluan përvojën e tyre koloniale franceze

---

[186] Më herët kemi parë se në Turqi ekziston ky model, ku konfliktet për kompetencë i zgjidh **Gjykatës për Zgjidhjen e Konflikteve të Juridiksionit të Turqisë**;
Kjo gjendje në vendet frankofone të **Afrikës** ka vlejtur vetëm sa i përket gjyqësisë kushtetuese dhe mekanzmave institucionalë për vënien e saj në jetë. Sa i përket organizimin politik të vendeve frankofone të Afrikës, megjithatë, gjendja ka qenë ndryshe: këtu vendet në fjalë kanë kopjuar dhe maksimalisht kanë importuar tiparet e modelit francez të organizimit politik. Cf. Yuhniëo Ngenge, "International Influences and the Design of Judicial Review Institutions in Francophone Africa" *American Journal of Comparative Law* Vol. 61 No. 2 (Spring 2013) fq. 433-460 në. fq. 442.

[187] Cf. Ibid. fq. 441-444; Në lietarturë me shumë të drejtë është vërejtur se **konstitutcionalizmi gjyqësor** i vendeve frankofone të Afrikës, ku gjyqësori pas vitit 1990 ka marrë një rol të madh në këto vende me qëllim të vënies në jetë të dispozitave të reja kushtetuese që synojnë kontrollin gjyqësor të pushtetit dhe fuqizimin e rolit të in dhe fuqizimin e rolit të individi në shoqëri, nuk mjafton: vendet në fjalë kanë nevojë për konstitucionalizëm strukturor, me të cilin nënkuptohet themelimi i strukturave të pushtetit që do të frenonin do të frenonin hegjemoninë e ekzekutivit dhe shtetin unitar të centralizuar. it do të bëhej shpërndarja horizontale dhe vertikale e pushtetit. Kjo në **Afrikë**, megjithatë, nuk ka ndodhur sepse, pas mbarimit të **Luftës së Ftohtë,** fokusi i reformave kushtetuese dhe i luftës për konstitucionalizëm ka qenë kryesisht i orientuar kah gjyqësia, përkatësisht në drejtim të ndërtimit të një **konstitutcionalizmi gjyqësor**, jo të një **konstitucionalizmi strukturor.** Ky i fundit konsiston në reformimin e strukturave të pushtetit politik me qëllim të shpërndarjes së pushtetit në nivel horizontal dhe vertikal në mes të akterëve të ndryshëm të shoqërisë, përfshirë këtu edhe përmirësimin e rolit dhe pozitës së individit në kuadër të kësaj shpërndarje të re të pushtetit (përkatësisht garantimi dhe mbrojtja e lirive dhe të drejtave individuale). Megjithatë, preokupimi kryesor i këtyre vendeve vetëm me kontrollin gjyqësor të kushtetutshmërisë, si i vetmi instrument për kontroll të pushtetit shtetëror, nuk merr parasyshë kufizime tjera objektive të procesit gjyqësor, të cilat janë imanencë e çdo procesi të tillë dhe të cilat ekzistojnë krahas defekteve strukturore të konstitucionalizmit në secilin vend. Cf. më shumë për këtë në studimin elokuent empirik të H. Këasi Prempeh, "*Marbury* in Africa: Judicial Review and the Challenge of Constitutionalism in Contemporary Africa". *Tulane Law Review* Vol. 80 No. 1 (2006) fq. 2-84.

[188] Ibid. fq. 21-36. Në këtë artikull hulumtues, autori diskuton pikëpamjet që fajsojnë gjyqësorin afrikan, kryesisht **anglofon**, për dështim në mbrojtjen e vlerave të konstitutcionalizmit modern përmes legjitimimit të diktaturave ushtarake dhe sistemeve autoritare afrikane. Në analizën e vet, autori konstaton se, megjithatë, kanë qenë faktorët tjerë objektiv dhe strukturor që duhen fajësuar për dështrimin e **konstitucionalizmit afrikan**. Në rend të parë këtu hyjnë kërkesat e liderëve të rinj afrikan për unitet nacional dhe interritet territorial të vendeve të tyre, të cilat pas pavarësimit janë rrezikuar një kohë të gjatë nga lëvizjet separatiste, pastaj vijnë mungesa e një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm, mungesa e kulturës së përgjithshme për sundim të ligjit dhe kështu me radhë.

[189] Cf. "(IX) COMMISSION DES LOIS ET DES AFFAIRES CONSTITUTIONNELLES. (C) LA COUR CONSTITUTIONELLE", botuar në Le Fondation Friedrich Nauman*, LES ACTES DE LA CONFERENCE NATIONALE* (Cotonou, du 19 au 28 Fevrier 1990) (Editions ONEPI, 1990: Cotonou, République du Bénin); Për komentet e kësaj konference dhe shpërndarjen e përvojës së saj me krijimin e gjyqësisë së ndarë kushtetuese në **Afrikën Perëndimore**, qoftë në formën e këshillit kushtetues apo të gjykatës kushtetuese, shih më shumë në Anna Rotman, "Benin's Constitutional Court: An Institutional Model for Enforcing Human Rights" (November 12, 2003). *Bepress Legal Series.* Working Paper 104. Në internet:http://law.bepress.com/expresso/eps/104 (shikuar në gusht 2017).

mbi organizimin shtetëror, përfshirë gjyqësinë e ndarë kushtetuese. Ky aktivitet shtetëror u pa si një inspirim për krijimin e mekanizmave të domosdoshëm për forcimin e demokracive të tyre të brishta dhe lënien pas shpine të praktikave diktatoriale si mjet për krijim të kohezivitetit social.[190]

Me këtë kthesë, gjyqësorit të pavarur dhe mekanizmave të tij iu dha një hapësirë e madhe, duke parë në te shpresën e vetme për konsolidim të shoqërive të tyre. Krahas forcimit të pavarësisë së gjyqësorit të rregullt, vendet frankofone nisën punën serioze për ndërtimin e mekanizmave të gjyqësisë kushtetuese si mënyrë për kontrollin e pushtetit politik dhe sigurimin e një pozite dhe rolit ytë ri për individin në shoqëri. Këto përpjekje serioze u reflektuan në kushtetutat e këtyre vendeve dhe u paraqitën si garancione kushtetuese, të cilave u nevojitej një mekanizëm gjyqësor për t'u siguruar se nuk do të hiqeshin nga pushteti politik në rastet e krizave dhe gjendjeve të jashtëzakonshme. Këto garancione kushtetuese u bënë standard jetese në vendet e Afrikës **frankofone**, kurse mekanizmat për vënien e tyre në jetë pjesë përbërëse e përpjekje për qeverisje të mirë dhe sundim të ligjit. Disa nga këto vende vendosën për gjykata të ndara kushtetuese,[191] disa të tjera për këshilla kushtetuese.[192] Në këtë kuptim, fillimi i viteve '90 të shekullit të kaluar, kur nisi procesi i demokratizimit në këtë pjesë të botës, në literaturë u cilësua si **vala e tretë e demokratizimit**,[193] ku kontrolli i kushtetutshmërisë merr një vend të spikatur në kushtetutat e reja afrikane, pa marrë parasysh formën institucionale të shprehjes së këtij kontrolli (gjykatë e ndarë kushtetuese apo pjesë e gjyqësorit të rregullt). Rikujtojmë se kjo valë përfshiu edhe vendet ish-komuniste evropiane, si dhe vendet e **Amerikës Latine** dhe **Azisë** që kanë përqafuar gjyqësinë kushtetuese si mekanizëm të kontrollit të pushtetit me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së kushtetutës dhe garancioneve të saj.

Dallojnë format institucionale të shprehjes së kontrollit kushtetues në Afrikë, qoftë në pjesën anglofone apo në atë frankofone. Modeli francez i këshillave kushtetuese ka qenë më i përhapur në pjesën **frankofone** të Afrikës: në shumicën e rasteve, këto vende nuk kanë zgjedhur rrugën e ruajtjes së gjyqësisë unike me gjykatën supreme në krye, por kanë krijuar juridiksion të ndarë kushtetues në njërën prej dy format të manifestimit të tij: gjykatë kushtetuese dhe këshill kushtetues. Në pjesën **anglofone**, ndërkaq, ka pasur një standard tjetër: gjyqësinë kushtetuese e kanë ushtruar të gjitha gjykatat e organizuara në një sistem hierarkik gjyqësor që është tipik për sistemin e të **drejtës së përgjithshme**.[194]

Ky tranzicion, i mundësuar në përmasa globale, jo vetëm në kontinentin afrikan, pas kolapsit të komunizmit dhe mbarimit të **Luftës së Ftohtë** (një pjesë bukur e madhe e vendeve afrikane kanë qenë diktatura të majta komuniste), ofroi mundësi të mëdha për zhvillim demokratik dhe kushtetues të shteteve. Në kuadër të këtyre zhvillimeve demokratike dhe kushtetuese bën pjesë edhe rilindja e gjyqësisë së fortë kushtetuese afrikane, kryesisht në pjesën **frankofone** si pasojë e ndikimit kulturor francez dhe traditës franceze mbi kontrollin abstrakt dhe preventiv të kushtetutshmërisë së ligjeve.[195]

---

[190] Babacar Kante, "Models of Constitutional Jurisdiction in Francophone West Africa". *Journal of Comparative Law* Volume 3 Issue 2 (2008) fq. 158-173 në fq. 161, 164.

[191] Gjykata Kushtetuese kanë këto vende në **Afrikën Perëndimore**: **Benini** (1990), **Mali** (1994), **Nigeri** (1999), **Guinea** (2010), **Sao Tome & Principe**(2005), **Togo** (1997)

[192] Këshilla Kushtetuese kanë këto vende në **Afrikën Perëndimore: Senegali** (1992**), Bregu i Fildishtë** (1994), **Burkina Faso** (2000), **Mauritania** (1991). Në literaturë është vërejtur se këshillat kushtetuese, aty ku ekzistojnë, kanë më pak fuqi se gjykatat kushtetuese. Cf. Babacar Kante, "Models of Constitutional Jurisdiction in Francophone West Africa", fq. 165.

[193] Kjo shprehje i atribuohet politologut të njohur amerikan, **Samuel Huntington**, të cilën e ka përdorur në analizën e vet të marrëdhënieve ndërkombëtare gjatë shekullit njëzet. Për kontekstin afrikan, cf. më shumë në Adem Kassie Abebe and Charles Manga Fombad, "The Advisory Jurisdiction of Constitutional Courts in Sub-Sahara". *George Washington International Law Review* Vol 46 No. 1 (2013) fq. 55-117 në fq. 65 (fusnota 66 dhe literatura e cituar aty).

[194] Charles M. Fombad, "The Evolution of Modern African Constitutions: A Retrospective Perspective". Në Charles M. Fombad, (ed.), *Separation of Powers in African Constitutionalism* (Oxford University Press: Oxford, 2016) fq. 13-57 në fq. 48-50.

[195] Jo vetëm kaq: vendet **frankofone** të **Afrikës** kanë huazuar edhe nga modeli **evropian/kelzenian** i gjyqësisë kushtetuese, juridiksioni i të cilave tejkalon dukshëm modelin klasik francez të fokusuar kryesisht në kontrollin preventive të kushtetutshmërsë së ligjeve. Cf. Kassie Abebe and Charles Manga Fombad, "The Advisory Jurisdiction of Constitutional Courts in Sub-Sahara", fq. 66-67.

Arsyeja imediate e kësaj rilindje është krejtësisht e njëjtë me arsyet pse vendet evropiane përqafuan gjyqësinë e fortë kushtetuese me juridiksion të ndarë dhe të qartë me qëllim kontrollin e abuzimit të pushtetit, diçka që kishte ndodhur në të kaluarën: diktaturat ushtarake afrikane gjatë tërë kohës së **Luftës së Ftohtë** kishin abuzuar me pushtetin, në mënyrë të njëjtë siç kishin bërë diktaturat evropiane gjatë dhe pas **Luftës së Dytë Botërore** deri me rënien e komunizmit në vitin 1990.[196]

Nisja e kësaj vale të re të demokratizimit dhe liberalizmit në **Afrikë** pas vitit 1990, në aspektin kushtetues është shoqëruar me nxjerrjen e kushtetutave të reja (apo amendamentimin substancial të kushtetutave të vjetra). Këto tekste të reja kushtetuese karakterizohen me diferencimin e rrugëve të zhvillimit ndërmjet vendeve **frankofone** dhe atyre **anglofone**. Në pjesën frankofone, instrumentet dhe mekanizmat e rinj të gjyqësisë kushtetuese u parashikuan me dispozita të reja kushtetuese me qëllim të adresimit të çështjeve fundamentale lidhur me bazën e legjitimitetit të pushtetit dhe kontrollit ndaj mënyrës së ushtrimit të tij, rolin dhe pozitën e individit në shoqëritë që tanimë po kalonin nëpër tranzicion të përgjithshëm socio-politik dhe ekonomik.[197] Në pjesën **anglofone**, kushtetutat e reja ruajtën modelin britanik të kontrollit dhe balancimit të pushtetit, të sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë, duke i lënë gjyqësorit të pavarur një vend të merituar, gjithnjë në respektim të supremacisë (epërsisë) së organit përfaqësues.

Në realizimin e objektivave kushtetuese, gjyqësia me juridiksion të ndarë kushtetues, kryesisht të centralizuar, ka pasur dhe ka një rol të veçantë. Kjo rëndësi shihet sa i përket sigurimin e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës përmes kontrollit kushtetues abstrakt, kontrollit kushtetues të veprimit apo mosveprimit administrativ, si dhe të kontrolleve të tjera kushtetuese të pushtetit dhe proceseve politike, siç janë, ta zëmë, kontrolli kushtetues i zgjedhjeve (parlamentare dhe presidenciale), i referendumeve, i gjendjeve të jashtëzakonshme, i partive politike etj. Në thelb, dallimi i këtyre dy sistemeve juridike, **frankofon** dhe **anglofon**, pa harruar këtu vendet afrikane që kanë qenë nën sundimin **portugez**, konsiston në dallimet e modaliteteve të kontrollit kushtetues të pushtetit ligjvënës dhe ekzekutiv (ky i fundit, pushteti ekzekutiv, në të shumtën e rasteve ka karakter presidencial). E thënë me fjalë të tjera, vendet frankofone dhe anglofone të Afrikës, si dhe ato që kanë qenë nën kolonializmin portugez, dallojnë nga njëra-tjetra sa i përket modaliteteve të kontrollit kushtetues që kanë përqafuar. Në modalitete hyjnë edhe mekanizmat institucionalë që kanë krijuar për vënien në jetë të një sistemi respektiv të gjyqësisë kushtetuese, qoftë ai amerikan, evropian/kelsenian apo i përzier (hibrid). Në ndërkohë që në vendet që kanë sistem të ndarë të gjyqësisë kushtetuese, ai model quhet **kontrolli kushtetues**, në vendet tjera që përqafojnë modelin e përbashkët të gjyqësisë kushtetuese apo të përzier, modeli quhet **kontroll gjyqësor**. Këto i kemi diskutuar në kapitujt fillestarë të librit, ashtu që krejt ajo që është thënë atje, vlen edhe në kontekstin afrikan.

Me përjashtim të **Afrikës së Jugut** dhe **Kenias**, në vendet **anglofone** ende ruhet supremacia (epërsia) e parlamentit, ku juridiksioni kushtetues është difuz (i decentralizuar) dhe ka të bëjë me zgjidhjen e rasteve dhe mosmarrëveshjeve konkrete së bashku me ato kushtetuese. Në vendet **frankofone** (dhe vendet tjera që janë në kuadër të sistemit kontinental të së drejtës) nuk ka supremaci (epërsi) të një organi ndaj tjetrit ashtu që dhe juridiksioni kushtetues paraqitet domosdoshmërish dhe kryesisht si juridiksion abstrakt dhe i centralizuar (koncentruar), ku kontrolli kushtetues ushtrohet nga një gjykatë apo këshill kushtetues, si organ me monopol ekskluziv për ushtrim të kontrollit kushtetues të normave juridike, veprimeve dhe mosveprimeve të organeve shtetërore, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mes të organeve shtetërore, veprimeve të partive politike, referendumeve dhe zgjedhjeve etj.).[198]

---

[196] Cf. Yuhniëo Ngenge, "International Influences and the Design of Judicial Review Institutions in Francophone Africa", fq. 444-445.

[197] Aborisade Olasunkanmi, "Appraisingg Constitutionalism and Good Governance in Africa". *International Journal of Interdisciplinary Research Methods* Vol.2 No. 2 (June 2015) fq. 9-15; Aborisade Olasunkanmi, "Constitutionalism and the Challenges of Development in Africa". *International Journal of Politics and Good Governance* Vol. 5 No. 5. 4 Quarter IV (2014) fq. fq. 1-9.

[198] Cf. Kassie Abebe and Charles Manga Fombad, "The Advisory Jurisdiction of Constitutional Courts in Sub-Sahara", fq. 81-95; 113..

Në vendet **frankofone**, gjyqësia kushtetuese paraqitet si relativisht homogjene dhe me karakteristika mjaft të ngjashme. Këtë e kanë vërejtur hulumtimet e bëra empirike, të cilat kanë shënuar një ngjashmëri mjaft të lartë në fizionominë e përqafuar të gjyqësisë kushtetuese dhe të qeverisjes në përgjithësi.[199] Kjo ngjashmëri e shënuar ndodhë në një hapësirë ku, megjithatë, institucionet dhe praktikat tradicionale vendore nuk kanë qenë pa ndikim.[200] U mor vesh, ndikimi francez ka qenë vendimtar dhe kjo shihet nga fakti i përhapjes së modelit të këshillave kushtetuese në vendet **frankofone**, ani se autorët e ndryshëm me të drejtë kanë vërejtur se ky ndikim nuk ka qenë pa modifikime: dizajni i kontrollit të kushtetutës ka disa karakteristika të tjera, të cilat mishërojnë jo vetëm veçoritë dhe traditat lokale, por edhe përvojat dhe zgjidhjet e modelit **evropian/kelenian**. Meritat kryesore për këtë dizajn hibrid të kontrollit të centralizuar (koncentruar) të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe normave tjera juridike i ka, pa asnjë dyshim, bashkësia ndërkombëtare dhe ndikimi që ka pasur ajo në procesin e draftimit të kushtetutave të reja të këtyre vendeve apo gjatë amendamentimit të tyre substancial pas vitit 1990. Roli i **Francës** në kuadër të bashkësisë ndërkombëtare ka qenë i veçantë, për shkak të historisë së saj me vendet ish-koloniale të **Afrikës Perëndimore**. E thënë me fjalë të tjera, në të shumtën e rasteve, kopjimi dhe imitimi i modelit francez është shoqëruar me modifikime të mëdha në drejtim të kopjimit dhe imitimit të zgjidhjeve **evropiane/kelseniane**, duke ua njohur gjykatave dhe këshillave të reja kushtetuese të drejtën e kontrollit represiv kushtetues dhe duke paraparë rregulla liberale për qasjen në gjykatë, përfshirë këtu vënien në lëvizje të gjykatës sipas detyrës zyrtare (rregullat e ashtuquajtura **auto-saisine** dhe **saisine d'office**). Një pjesë tjetër më e vogël e këtyre vendeve kanë imituar dhe kopjuar në mënyrë besnike modelin francez, duke bërë modifikime fare të vogla. Në këtë grup hyjnë: **Burikna Faso**, **Kameruni**, **Komoro**, **Mali** dhe **Mauritania**, kurse në grupin vendeve që kanë futur kontrollin represiv krahas atij preventiv sipas modelit francez dhe që kanë futur rregulla më liberale për qasje sa më të gjerë në gjykatë hyjnë: **Benini, Burundi, Republika e Afrikës Qendrore, Çadi, Kongo, Xhibuti, Guinea Ekuatoriale, Gaboni, Bregu i Fildishtë, Madagaskar, Nigeri, Senegali** dhe **Togo.**[201]

Ajo që karakterizon juridiksionet kushtetuese të vendeve **frankofone,** është se në këto vende tekstet kushtetuese flasin për supremacinë (epërsinë) e kushtetutës dhe kërkojnë që çdo ligj të jetë në pajtim me kushtetutën. Kontrolli i normës ligjore dhe i normave të tjera mund të jetë preventiv dhe represiv, ani se kjo e fundit (kontrolli konkret incidental i kushtetutshmërisë) në këto vende është më i rrallë.[202] Kjo është e kundërt me vendet e **anglofone**, në të cilat ende është ruajtur supremacia (epërsia) e parlamentit. Mekanizmi për realizimin e veprimit të kontrollit kushtetues ka formën e kontrollit gjyqësor dhe është shumë i dobët, difuz (i decentralizuar), pa ndonjë rol të

---

199 Cf. për të përbashkëtat dhe dallimet në artikullin studimor të Babacar Kante, "Models of Constitutional Jurisdiction in Francophone West Africa", fq. 161-163. Këtu, në këto faqë të shkrimit, autori flet për të përbashkëtat dhe të veçantat e modelit kushtetues afrikan frankofon, duke nënvizuar se në shumicën e rasteve gjykatat nuk kanë të drejtën e kontrollit konkret (si pasojë e ndikimit francez) si të drejtën për dhënien e mendimeve konsultative lidhur me interpretimin e kuptimit të dispozitave të caktuara kushtetuese që kanë të bëjnë me funksionet dhe mënyrën e ushtrimit të tyre nga ana e organeve kushtetuese.

200 Charles M. Fombad, "The Evolution of Modern African Constitutions: A Retrospective Perspective", fq. 33-41.

201 Cf. për këtë studimin e detajuar empirik që tregon se meritat kryesore për këtë dizajn hibrid të kontrollit kushtetues i ka, pa asnjë dyshim, Bashkësia Ndërkombëtare dhe ndikimi i saj në procesin e draftimit të kushtetutave të reja të këtyre vendeve apo të amendamentimit substancial të tyre pas vitit 1990. Studimi i referohet tetëmbëdhjetë vendeve **frankofone** të Afrikës së subsaharane. Yuhniwo Ngenge, "International Influences and the Design of Judicial Review Institutions in Francophone Africa", fq. 433-460 dhe 445-459.

202 Për më tepër, jo vetëm në vendet frankofone, por edhe në vendet tjera të Afrikës ekziston edhe kompetenca këshilluese e gjyqësisë kushtetuese. Në vendet frankofone kjo kompetencë ka qenë më e natyrshme nisur nga fakti i ndikimit francez dhe ngjashmërisë së kësaj kompetence me kontrollin preventive të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe normave tjera juridike. Me këtë kompetencë nënkuptohet procedura gjyqësore kushtetuese e cila iu mundëson organeve politike të shtetit që të marrin udhëzime dhe sqarime lidhur me çështjet juridike-kushtetuese jashtë ekzistimit të një rasti apo mosmarrëveshje kushtetuese aktuale, me qëllim që të pengohet adresimi i dëmit që mund të shkaktohej nga mospasja e një mendimi autoritativ këshidhënës lidhur me atë çështje juridiko-kushtetuese. Cf. Kassie Abebe and Charles Manga Fombad, "The Advisory Jurisdiction of Constitutional Courts in Sub-Sahara", fq. 58-59 dhe 65-75.

veçantë të dukshëm kushtetues. Kontrolli dhe frenimi i pushtetit politik realizohet, sipas kushtetutave të vendeve anglofone, përmes mekanizmave të kontrollit parlamentar dhe institucioneve kushtetuese hibride, siç janë ombuspersoni, agjensionet kundër korrupsionit etj.[203]

Cilësia e dytë e juridiksionit kushtetues në vendet **frankofone** është se ky juridiksion është krijuar me të vetmin qëllim për të shërbyer si një rregullator i sistemit politik në mënyrë që të pengohet rrëshqitja e tyre në një diktaturë të re. Ky juridiksion është krijuar për të penguar rikthimin e regjimeve të vjetra autoritare, nën të cilat këto vende kanë jetuar në të kaluarën.[204] Kjo është arsyeja pse ky juridiksion kushtetues i këtyre vendeve shumë pak ka pasur të bëjë me mbrojtjen dhe promovimin e lirive dhe të drejtave të njeriu. Kjo në literaturë është vërejtur se ai i tillë ngelet edhe sot e kësaj dite, përkatësisht se ka të bëjë kryesisht me zgjidhjen e konflikteve në mes të organeve shtetërore dhe konfirmimin e rezultateve zgjedhore (parlamentare dhe presidenciale) si dhe rezultateve të referendumeve.[205]

Përveç këtij koncentrimi të juridiksionit kushtetues në çështjet që kanë të bëjnë e organizimin e pushtetit shtetëror dhe mënyrën e ushtrimit të tij, ekzistojnë edhe disa segmente të tjera që shpërfaqin dobësitë e gjyqësinë kushtetuese të vendeve frankofone. Në mesin e tyre hyjnë, sipas studiuesve empirikë, metodat dhe teknikat e punës: zbatimi tekstual apo **ad literam** i dispozitave kushtetuese në këto vende është përgjithësisht i njohur, siç është, në fakt, në shumicën e vendeve që i takojnë sistemit të së **drejtës civile** (kontinentale). Kjo nuk do të thotë se vendet **anglofone** janë më imune ndaj zbatimit tekstual apo **ad literam** të dispozitave kushtetuese.[206] Në këtë kuptim dy grupimet e sipërcekura të vendeve afrikane, frankofone dhe anglofone, dukshëm dallojnë nga vendet e avancuara perëndimore, në të cilat e drejta kushtetuese pozitive paraqet një amalgamë të jurisprudencës, që vjen si pasojë e interpretimit **objektiv teleologjik** të dispozitave kushtetuese nacionale.[207] Në vendet perëndimore, interpretimi **subjektiv teleologjik** (kuptimi që e ka pasur parasysh hartuesi i tekstit, jo kuptimi që ka parasysh interpretuesi), i njohur ndryshe si interpretimi **ad literam** (tekstual) i dispozitave kushtetuese, është i theksuar shumë më pak.

Këto të meta hasen edhe në gjyqësinë kushtetuese në **Kosovë**, për çka flasim në dy kapitujt e fundit të këtij libri, në të cilat diskutohet dhe analizohet praktika gjyqësore kushtetuese ndër ne dhe tipologjitë e arsyetimeve të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese (kapitulli gjashtëmbëdhjetë).

---

[203] Cf. më shumë për këtë në: Charles M. Fombad, "The Role of Emerging Hybrid Institutions of Accountability in the Separation of Powers Scheme in Africa". Në Charles M. Fombad, (ed.), *Separation of Powers in African Constitutionalism,* fq. 89 dhe 325 -344.

[204] Babacar Kante, "Models of Constitutional Jurisdiction in Francophone West Africa", fq. 165-166.

[205] Ibid. fq. 158-160. Rasti i **Gjykatës Kushtetuese të Beninit**, zakonisht merret si shembull i një gjykate në një vend frankofon afrikan që ka qenë aktive në mbrojtjen dhe promovimin e të dretave të njeriut dhe në kontrollin e veprimit administrative të shtetit. Ibid. fq. 170; James Foëkes and Charles Fombad, "Introduction". Në Charles M. Fombad, (ed.), *Separation of Poëers in African Constitutionalism*, fq. 1-9 në fq. 2; Horace Adjolohoun and Charles M. Fombad, "Separation of Poëers and Position of the Public Prosecutor in Francophone Africa". Në Charles M. Fombad, (ed.), *Separation of Poëers in African Constitutionalism*, fq. 359- 384 në fq. 366; Cf. poashtu edhe analizën empirike të autores Anna Rotman, "Benin's Constitutional Court: An Institutional Model for Enforcing Human Rights".
Në pjesën anglofone, **Afrika e Jugut** dallohet në këtë drejtim: **GJKAJ** ka një rekord të jashtëzkonshëm në mbrojtjen dhe promovimin e lirive dhe të drejtave të njeriut.

[206] Prirja kah **interpretimi tekstual**, i njohur ndryshe edhe si **interpretim positivist**, i dispozitave kushtetuese duhet të jetë më shumë pasojë e edukimit juridik të shablonizuar që është zhvlluar në vendet dikatatoriale (qofshin ato diktatura ushtarake apo diktatura ideologjike, sic kanë qenë ato komuniste). Cf. më shumë për interpretimet kushtetuese pozitiviste dhe jo-pozitiviste në dy vende anglofone të Afrikës si pasojë e përvojës së tyre me edukatën legale nën diktaturë ushtarke, **Nigerinë** dhe **Ganën,** te Atupare Atudiwe P., Courts, "Interpretation and Constitutions in Africa: A Focused Inquiry into Comparative Constitutional Interpretation in Ghana and Nigeria, *Review of Ghana Law*wVol. 22 (2006-2010) fq. 97 – 134 në veçanti 101, 116 dhe 133.

[207] Babacar Kante, "Models of Constitutional Jurisdiction in Francophone West Africa", fq.171.

8.10. Komente dhe pyetje

8.10.1. Në këtë kapitull kemi përzgjedhur disa vende dhe sistemet e tyre të gjyqësisë kushtetuese, sipas disa kritereve. Në **Afrikë** këtë radhë jemi fokusuar në vendet frankofone të saj. Pse?

8.10.2. Afrika e Jugut bën përjashtim nga diskutimi ynë vendeve frankofone të **Afrikës**. Cilat janë arsyet që e kemi përzgjedhur këtë vend për ta diskutuar në këtë kapitull?

8.10.3. Në mënyrë të njëjtë, pra sipas disa kritereve që kanë logjikë komparative, kemi përzgjedhur edhe **Kinën** e **Tajvanin**, duke përjashtuar **Korenë e Veriut**. Kemi dhenë arsyetim për këtë, diçka që ka të bëjë me natyrën e tri regjimeve: Kinës, Koresë së Veriu dhe Tajvanit. Për çfarë kriteresh bëhet fjalë këtu?

8.10.4. Pas rënies së komunizmit, disa vende në Azinë Juglindore kanë përzgjedhur një dizajn të gjyqësisë kushtetuese që i bën më specifike kundrejt vendeve tjera me traditë në gjyqësinë kushtetuese. Ky dizajnë kohëve të fundit, pas vitit 2012, ka nisur zbatimin edhe në Turqi, kurse në Izrael ka një traditë të madhe që nga koha e vendimit të vitit 1995, i njohur si rasti **United Mizrachi Bank v. Migdal Cooperative Village**. Cila specifikë e dallon rastin e **Turqisë** dhe **Izraelit** nga gjykatat tjera të **Azisë**?

8.10.5. Turqia ka një histori të gjatë me gjyqësinë kushtetuese, e cila ka nisur qysh me Kushtetutën e Perandorisë Otomane të vitit 1876. Cila ka qenë situata me kushtetutat e mëvonshme të Turqisë sa i përket gjyqësisë kushtetuese?

8.10.6. Çfarë nënkupton koncepcioni elitist i gjyqësisë kushtetuese në Turqi, që nga themelimi i saj e deri te ndryshimet e fundit dramatike të rolit dhe pozitës së GJKTr?

8.10.7. Cilat kanë qenë arsyet për futjen e **ankesës kushtetuese** në sistemin kushtetues turk dhe në cilin vit ka ndodhur kjo?

8.10.8. Kushtetuta e vitit 1982, aktualisht në fuqi, ka disa cilësi që e bëjnë të veçantë kur flitet për gjyqësinë kushtetuese të këtij vendi? Cilat janë cilësitë e saj në lëmin e gjyqësisë kushtetuese dhe në cilin drejtim ka ndryshuar gjyqësia kushtetuese turke pas amendamenteve të vitit 2010 dhe 2017? Cili ka qenë roli i **Komisionit të Venecias** në këto amendamentime?

8.10.9. Në **Izrael** nuk ka një kushtetutë të shkruar. Kjo gjendje aktuale diktohet nga situata në të cilën ka lindur dhe është zhvilluar shteti izraelit. Pikënisje e këtij zhvillimi paraqet **Deklarata Harari**, e cila spjegon arsyen e mospasjes së një kushtetute të shkruar. Përveç kësaj, kjo deklaratë ka lënë të hapur shumë çështje tjera që lidhen me gjyqësinë kushtetuese. Diskutoni lindjen e kësaj deklarate, formën dhe përmbajtjen e saj dhe rëndësinë e saj kushtetuese?

8.10.10. Njohja e të drejtës për kontroll të kushtetutshmërisë së ligjeve përmes precedentit gjyqësor nuk është rast i panjohur në gjyqësinë kushtetuese bashkëkohore. Si rast i parë përmendet **Marbury vs Madison**. Në mënyrë të ngjashme është futur instituti i kontrollit të kushtetutshmërisë në Izrael. Kjo i dedikohet dy koncepteve të cilat ishin futur në sistemin juridik izraelit: klauzola e rrënjosur dhe shumica e caktuar parlamentare si kusht për miratimin e ligjeve në mënyrë të vlefshme. Diskuto këto dy koncepte dhe rëndësinë e tyre për zhvillimin e gjyqësisë kushtetuese në **Izrael.**

8.10.11. Këto dy koncepte, megjithatë, nuk kanë themeluar institutin e gjyqësisë kushtetuese në Izrael. Kjo ka ndodhur më vonë si pasojë e miratimit të dy ligjeve në vitin 1992 dhe një vendimi të **GJSIz**, i njohur si **United Mizrachi Bank v. Migdal Cooperative Village.** Ky vendim, i cili ka interpretuar këto dy ligje, i ka shërbyer doktrinës kushtetuese në **Izrael** për të ndërtuar standardin kushtetues për kontroll të kushtetutshmërisë së ligjeve, duke përcaktuar se kush mund të jetë palë e autorizuar dhe cilat janë bazat në të cilat mund të mbështetet kërkesa për inicim të procedurës në kontroll të kushtetutshmërisë së ligjeve. Kjo për faktin se në **Izrael** nuk ka një ligj organik me të cilin përcaktohen palët e autorizuara dhe juridiksioni i **GJSIz** në çështjet kushtetuese. Thënë ndryshe, doktrina e këtij vendi ka plotësuar

zbrazëtinë juridike si pasojë e mungesës së një ligji organik që do të rregullonte në mënyrë gjithëpërfshirëse jo vetëm palët e autorizuara dhe juridiksionin e **GJSIz** në lëmin kushtetues, por edhe organizmin dhe procedurat specifike në çështjet kushtetuese në nivel vendi. Për cilat ligje është fjala? Cila është përmbajtja e tyre? Cila është esenca e rëndësisë historike të vendimit në fjalë të **GJSIz** të vitit 1995? Mbi të gjitha, kush janë palët e autorizuara dhe cilat janë bazat në të cilat mund të mbështetet kërkesa për inicim të procedurës për kontroll të kushtetutshmërisë së ligjeve izraelite?

8.10.12. A ekziston në **Izrael** kontrolli abstrakt i kushtetutshmërisë së normave juridike?

8.10.13. Bazuar në praktikën e stabilizuar mirë përmes precedentëve të **GJSIz**, palët e autorizuara për të nisur kontrollin gjyqësor të kushtetutshmërisë së një ligji, ndryshojnë në vartësi të asaj nëse bëhet fjalë për **kontrollin e drejtpërdrejtë** apo për **kontrollin e tërthortë** të kushtetutshmërisë. Kush mund të paraqitet si palë në rastet e kontrollit të drejtpërdrejtë e kush në rastet e kontrollit të tërthortë të kushtetutshmërisë?

8.10.14. Vendet e Azisë Qendrore, të cilat diskutohen në këtë kapitull, përbëjnë një kolorit të zgjidhjeve institucionale në lëmin e gjyqësisë kushtetuese. Ky ka qenë ndër arsyet e para që i kemi përzgjedhur për diskutim. Krahas këtij kriteri, lokacioni i tyre gjeografik si hapësirë në mes të Evropës dhe Azisë Perëndimore, ka bërë që disa vende në fqinjësi me to të trajtohen së bashku me vendet e Azisë Qendrore. I tillë është rasti i Azerbajxhanit dhe Mongolisë. Këto të fundit, i kemi trajtuar edhe për një kriter tjetër, kriterin ideologjikë dhe ndikimit sovjetik në sistemet juridike dhe kushtetuese të këtyre vendeve. Diskuto në përgjithësi kriteret e përzgjedhjes së vendeve që diskutohen në këtë seksion mbi Azinë Qendrore!

8.10.15. **Azerbajxhani** ka një juridiksion të gjerë kushtetues, ngjashëm me juridiksionin që ka Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Megjithatë, ka disa dallime, në veçanti sa i përket ankesës kushtetuese. Në çka konsistojnë këto dallime në mes të **ankesës kushtetuese kosovare** dhe asaj të përqafuar në Azerbajxhan?

8.10.16. Në Azerbajxhan, për t'u ushtruar **ankesa kushtetuese** duhet të shteren mjetet juridike në nivel nacional. Ka dy përjashtime nga kjo nga kjo rregull. Cilat janë ato?

8.10.17. Në **Kazakistan** ekziston një këshill kushtetues, i cili ka autorizim që të kryejë kontrollin preventiv të traktateve ndërkombëtare. Çka nënkupton kjo dhe a ka ngjashmëri me Kosovën?

8.10.18. **Taxhekistani** ka një gjykatë të ndarë kushtetuese, njëjtë si Azerbajxhani. Për dallim nga ky i fundit, në rastin e **Taxhekistanit** krahas Kushtetutës, edhe ligji organik i njeh **GKTa** kompetenca shtesë. Ndër këto kompetenca shtesë hyjnë edhe ato që kanë të bëjnë me kontrollin kushtetues të draft-amendamenteve kushtetuese. Në çka konsiston kontrolli kushtetues preventiv i draft-amendamenteve kushtetuese në rastin e Taxhekistanit?

8.10.19. A ka Taxhekistani **ankesë kushtetuese**? Nëse po, cilat janë palët e autorizuara për ta parashtruar atë dhe mbi cilat baza juridiko-kushtetuese?

8.10.20. Kirgistani paraqet vendin e parë ish sovjetik që ka themeluar gjyqësinë e ndarë kushtetuese, me juridiksion të posaçëm dhe të ndarë kushtetues. Kjo situatë, megjithatë, ka ndryshuar me Kushtetutën e vitit 2010 si pasojë e disa zhvillimeve të brendshme në këtë vend. Nga ky vit, në këtë vend ka një dhomë kushtetuese brenda Gjykatës Supreme. **GJKKir** u shpërbë si pasojë e dinamikave të brendshme politike. Cilat janë këto zhvillime dhe cilat ndryshime kanë pasuar në gjyqësinë kushtetuese të këtij vendi? A ka dallim në juridiksionin e **DHKGJSKir**, krahasuar me juridiksionin e **GJKKir** (1993-2010)? Në veçanti, tregoni për ankesën kushtetuese të këtij vendi, çfarë natyre ka ankesa dhe në çka konsiston?

8.10.21. Krahas vendeve të tjera që kemi diskutuar në këtë libër, **Indonezia** hyn në vendet që gjyqësinë kushtetuese në aspektin formal e normojnë së bashku me gjyqësorin e rregullt. Kjo, megjithatë, nuk ndryshon asnjë në natyrën e gjyqësisë kushtetuese indoneziane. Pse kjo është kështu dhe si reflektohet kjo në aspektin normativ të organizimit dhe funksionimit të **GJKIn** ? Cili është standardi i normimit në vendet që nuk kanë gjyqësi të ndarë kushtetuese por ajo ushtrohet nga gjyqësori i rregullt: a kanë këto vende ligje të veçanta organike për gjyqësinë kushtetuese nacionale apo kjo materie normohet me rregullat e brendshme të gjyqësorit të rregullt?

8.10.22. Ndër kompetencat kryesore të **GJKIn** bën pjesë kompetenca për kontrollin abstrakt të ligjeve. Ai kontroll abstrakt mund të përfshijë dy anën: anën e legalitetit të formimit të ligjeve dhe anën materiale të tyre. Çfarë do të thotë kjo dhe si krahasohet kjo kompetencë abstrakte e **GJKIn** me rastin e gjyqësisë kushtetuese në Kosovë?

8.10.23. **Koreja e Jugut** bën pjesë në vendet që relativisht vonë kanë futur në sistemin e tyre kushtetues gjykatën e ndarë kushtetuese me juridiksion të veçantë nga juridiksioni i gjyqësorit të rregullt. Kjo gjykatë, megjithatë, ka disa specifika, të cilat nuk i gjejmë në asnjë rast tjetër. Për cilat specifika juridiksionale flitet në rastin e **GKKJu**?

8.10.24. Cila është kompetenca e parë e **GJKKJu** dhe çfarë natyre kanë vendimet e marra në vijim të ushtrimit të kësaj kompetence? A mund të jenë palë të autorizuara gjykatat e rregullta apo kjo procedurë vihet në lëvizje vetëm përmes njërës prej gjykatave të rregullta të Koresë së Jugut?

8.10.25. Dispozita që ka të bëje me ankesën kushtetuese gjendet në nenin 111 të Kushtetutës dhe më tutje shtjellohet në nenet 68-75 të Ligjit. Nga leximi i dispozitës kushtetuese nuk mund të nxirret kuptimi i qartë sepse vetëm kuptimi i dispozitës në fjalë nuk është edhe aq i saktë. Në këtë dispozitë thuhet, **inter alia**, se **GJKKJu** vendos "[...] lidhur me peticionet që kanë të bëjnë me Kushtetutën, ashtu siç përcaktohet me ligj". Kjo, pra, nënkupton se Ligji është ai që sqaron se çka mund të jetë objekt i kontrollit kushtetues në një procedurë sipas **ankesës kushtetuese** dhe kush mund të jenë palët e autorizuara. Diskutoni!

8.10.26. Pse **ankesa kushtetuese** në sistemin kushtetues të **Koresë së Jugut** nuk është e tipit të plotë?

8.10.27. Me amendamentin e vitit 1988 në **Malajzi** janë bërë ndryshime të rëndësishme kushtetuese: amendamenti kushtetues në nenin 121 të **Kushtetutës së Malajzisë** të vitit 1957 (aktualisht në fuqi) bëri disa ndryshime me të cilat u prish orientimi laik i shtetit dhe u rrënua roli i gjyqësorit malajzian në sigurimin e supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës. Çfarë thuhet në këtë amendament dhe sa rende juridiko-kushtetuese ekzistojnë tani në **Malajzi** dhe cili është roli i **Sheriatit Islam**?

8.10.28. Në nenin 130 të Kushtetutës, në kuadër të kapitullit për gjyqësorin bëhet fjalë për të drejtën e monarkut malajzian për të kërkuar mendim këshillëdhënës prej **GJFM** lidhur me kushtetutshmërinë e një ligji. Në fakt, kjo dispozitë flet për të drejtën e monarkut për të kërkuar mendimin e tillë lidhur me çdo çështje kushtetuese, aktuale apo hipotetike. Kjo dispozitë mundëson që qysh në nisje të pengohet cenimi i Kushtetutës dhe është e ngjashme me dispozitën e diskutuar më herët të nenit 100 të **Kushtetutës së Singaporit**. Diskutoni!

8.10.29. Lidhur me mendimin këshillëdhënës si më sipër, në **Kushtetutën e Malajzisë** nuk thuhet, mirëpo nënkuptohet, ligjit që ka marrë një mendim pozitiv nga **GJFM** nuk mund t'i sfidohet kushtetutshmëria nga të tjerët në asnjë procedurë. A nënkupton kjo, në të njëjtën kohë, se ligjet që kanë marrë paraprakisht mendimin pozitiv si më sipër me kërkesën e monarkut, por që kanë natyrë islamike, mund të konsiderohen kushtetuese edhe atëherë kur hapur mund të cenojnë të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë? Nëse po, atëherë tregoni ndonjë rast nga praktika gjyqësore e këtij vendi!

8.10.30. **Mongolia** në gjyqësinë e vet kushtetuese ka disa specifika. Njëra ndër to lidhet me mundësinë e kontrollit kushtetues të traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare. Tjetra specifikë ka të bëjë me procedurën dyshkallëshe në procedurat e kontrollit abstrakt të ligjeve. Çfarë do të thotë kjo?

8.10.31. Sa i përket efekteve juridike të vendimeve të **GJKMon**, ekzistojnë disa specifika që e bëjnë shumë të veçantë. Vendimi i saj i dhënë gjatë ushtrimit të kompetencës së parë dhe të dytë i dërgohet Parlamentit për të dhënë mendimin e vet. Nëse ai nuk pajtohet me vendimin, atëherë **GJKMon** nxjerr vendim përfundimtar, i cili është i paapelueshëm dhe i detyrueshëm për të gjithë (**erga omnes**). Kjo procedurë parashikohet me dy paragrafët e fundit të nenit 66, paragrafët 3 dhe 4 të Kushtetutës. Ajo më tutje operacionalizohet me dy ligje të tjera, me të cilat vihen në jetë paragrafët e mësipërm kushtetues: **Ligji për Gjykatën Kushtetuese** (1992) dhe **Ligji për Procedurën në Gjykatën Kushtetuese** (1997). Në literaturë ka pasur mjaft vërejtje për këtë procedurë dyshkallëshe. Diskutoni!

8.10.32. Në Mongoli ekziston **actio popularis,** e cila mund të paraqitet jo vetëm nga zyrtarët shtetërorë por edhe nga çdo individ. Ky mjet juridik, në Kushtetutë cilësohet njëherë si "peticion" dhe herën tjetër si "informacion" që mund të paraqitet nga secili individ. Diskutoni! Në veçanti tregoni nëse në këtë vend ekziston **ankesa kushtetuese** dhe e cilit lloj?

8.10.33. Kina perandorake ka pasur një histori të pasur. Në këtë periudhë që ka zgjatur me shekuj dhe ka përfunduar në vitin 1912, kur është rrënuar nga forcat nacionaliste **Dinastia Han.** Kjo dinasti pati bërë të a.q. **konfuçianizim të ligjit** si politikë të saj zyrtare. Çfarë do të thotë kjo?

8.10.34. Kina komuniste në historinë e saj të ekzistimit që nga viti 1949, ka pasur disa kushtetuta të shkruara. Këto kushtetuta, megjithatë, nuk kanë garantuar dhe nuk garantojnë një sundim të ligjit në kuptimin modern të kësaj fjale e as që mund të flitet për ndonjë konstitucionalizëm të mirëfilltë të tipit perëndimor liberal. Atëherë, për çfarë bëhet fjalë këtu?

8.10.35. Çfarë thuhet në Preambulën e Kushtetutës së Kinës, aktualisht në fuqi? Si pajtohet supremacia (epërsia) e Kushtetutës me rolin dhe pozitën dominante të garantuar me Kushtetutë të **PKK**?

8.10.36. Nëse në **Kinë** nuk mund të bëhet fjalë për supremacinë (epërsinë) e Kushtetutës, atëherë për çfarë epërsie flitet?

8.10.37. Kjo, megjithatë, nuk do të thotë se në **Kinë** nuk ka kontroll të kushtetutshmërisë. Ai kontroll, siç mund të pritet, është politik dhe përfshin vënien në jetë dhe interpretimin e Kushtetutës. Për t'u realizuar ky kontroll, tri lloje të veprimeve mund të ndërmerren. Cilat janë ato veprime?

8.10.38. Në nenin e pestë të parimeve të përgjithshme të Kushtetutës së Kinës theksohet se çdo cenim i Kushtetutës dhe ligjeve duhet të hetohet. A paraqet kjo kontroll kushtetues politik apo bëhet fjalë diçka tjetër?

8.10.39. Në procesin e kontrollit politik kushtetues në **Kinë**, megjithatë, jo domosdo vjen deri të anulimi i dispozitave jokushtetuese. Ai anulim mund të ndodhë vetëm nga njëri prej dy organeve të përcaktuara dhe vetëm ndaj disa prej llojeve të normave dhe akteve juridike. Diskutoni!

8.10.40. Gjyqësori kinez, përfshirë në radhë të parë **GJSRPK,** ka një rol jashtëzakonisht jo qendror në sistemin kushtetues: ai vetëm zbaton ligjet, pa pasur të drejtën e interpretimit të tyre. Kush bën interpretimin e ligjeve në **Kinë**?

8.10.41. Rasti i **Tajvanit** përbën një rast shumë të veçantë si pasojë e zhvillimeve në Kinë pas ardhjes së komunistëve në pushtet në vitin 1949. Ky vit shënon një rrugëtim të ri në zhvillimin e gjyqësisë kushtetuese tajvaneze, i cili ka kaluar nëpër dy faza. Për cilat faza bëhet fjalë dhe cilat janë cilësitë e tyre?

8.10.42. **KGJM** në **Taivan** luan rolin e Gjykatës kushtetuese dhe ka juridiksion të ndarë dhe të veçantë nga juridiksionet tjera, qofshin ato juridiksione të përgjithshme (administrative, civile dhe penale) apo të veçanta (tregtare, ekonomike etj.). Cili është juridiksioni i **KGJM** dhe me cilat akte juridike definohet?

8.10.43. Në nenin 2 ["Formimi i Këshillit dhe i Gjykatës Kushtetuese"] të Ligjit të vitit 1993, përcaktohet detyra e të gjithë gjyqtarëve të **Gjyqësorit Yuan** për të bërë interpretimin e Kushtetutës si dhe interpretimin

uniform të ligjeve dhe rregulloreve të tjera. Kjo është fjalia e parë e paragrafit të vetëm të këtij neni. Në fjalinë e dytë të paragrafit të njëjtë përcaktohet mundësia e themelimit të një gjykate të veçantë kushtetuese për të shpallur shpërbërjen e një partie politike që vepron në kundërshtim me Kushtetutën. Kjo do të thotë se ky nen bën dallimin në mes të gjyqtarëve të **KGJM**, të cilët luajnë rolin e tyre të interpretuesit të Kushtetutës, dhe një trupi **ad hoc** që themelohet për të vepruar si gjykatë kushtetuese për qëllimin e sipër cekur (shpërbërjen e partive politike antikushtetuese). Neni në vijim i Ligjit të vitit 1993, përcakton se çka mund të jetë objekt i interpretimit kushtetues. Diskutoni se çka mund të jetë objekt i interpretimit kushtetues në Tajvan?

8.10.44. Gjyqësia kushtetuese e **Japonisë** është e kohës së re, si pasojë e të kaluarës tragjike dhe diktatoriale të këtij vendi. Vetëm pas **Luftës së Dytë Botërore** në këtë vend mund të thuhet se ka nisur gjyqësia kushtetuese. Sa i përket llojit të saj, modelit, një kohë të gjatë kjo çështje ka qenë e diskutueshme. Cilin model përfaqëson **Japonia** dhe cilat janë arsyet që kanë çuar në përqafimin e modelit të tillë në këtë vend?

8.10.45. GJSJa ka rolin kushtetues unifikues në çështjet që janë nën juridiksionin e saj sipas mjeteve juridike në instancë të fundit apo kur ushtron juridiksion origjinal në shkallë të parë dhe të fundit. Me fjalë të tjera, sikundër në rastet tjera të vendeve që modelohen sipas sistemit amerikan, **GJSJa** vetë nuk bën mosaplikimin e ligjeve si pasojë e jokushtetutshmërisë së tyre, sepse kjo e drejtë ushtrohet nga nivelet e ulëta të gjyqësorit, por kujdeset për interpretimin e Kushtetutës me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së saj në të gjitha procedurat gjyqësore që zhvillohen pranë saj sipas mjeteve të goditjes në shkallë të fundit apo gjatë ushtrimit të juridiksionit të saj origjinal (në shkallë të parë dhe të fundit). Vetëm në një rast deri më sot ka ndodhur mosaplikimi i ligjit si jokushtetues nga ana e saj: në rastin **Aizaëa v Japan** (1973). Kjo për shkak se, siç u tha, **GJSJa** kujdeset në shkallë të fundit për sigurimin e supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës, në rastet kur një gjë e tillë nuk është bërë nga ana e gjykatave më të ulëta. Kjo mbikëqyrje nuk bëhet duke mënjanuar nga faqja e dheut ligjin jo kushtetues, por duke ia mohuar atij vlefshmërinë juridike për rastet e mëpastajme. Janë tri situata kur vjen deri te mohimi i vlefshmërisë juridike të ligjit për të ardhmen. Diskutoni!

8.10.46. Në **Afrikën e Jugut**, gjyqësia kushtetuese përkundër disa specifikave ka shumë ngjashmëri me disa vende tjera që kanë kaluar nëpër diktatura dhe regjime diskriminuese. E kemi fjalën për modelin e përfaqësuar në këtë vend. Për çfarë ngjashmërisë në mes të **Afrikës së Jugut** dhe vendeve tjera të cilat kanë kapluar nëpër regjime diktatoriale bëhet fjalë?

8.10.47. Vetëm një nen i Kushtëtutës së vitit 1996, neni 167, normon juridiksionin e **GJKAJ**, përcakton fizionominë dhe mënyrën e vendimmarrjes së saj. Ky nen e bën atë të dallueshme kundrejt pjesëve të tjera të gjyqësorit nacional. Në pikën e tretë të këtij neni, në një mënyrë të saktë definohet juridiksioni i saj. Paragrafi i parë i tij, ndërkaq, e definon atë si gjykatën më të lartë në vend, kurse tjetri në vijim flet për caqet e vendimmarrjes së saj. Për çfarë mund të vendosë **GJKAJ** sipas nenit si më sipër të Kushtetutës?

8.10.48. Në paragrafin e katërt të nenit 167, Kushtetuta përcakton juridiksionin përjashtues të Gjykatës. Ky juridiksion përjashtues është taksativisht i numëruar dhe në mënyrë konkrete. Si i tillë, ai ka për qëllim që të eliminojë çdo dyshim se kompetencat e numëruara aty nuk mund t'i takojnë asnjë gjykate tjetër. Për këtë qëllim, dispozita e këtij paragrafi është skajshmërisht përjashtuese, duke treguar se çfarë mund të vendoset ekskluzivisht nga **GJKAJ,** duke përjashtuar çdo gjykatë tjetër në vend. Vetëm ajo mund të vendosë, thuhet në paragrafin e katërt, për gjashtë çështje, të cilat ju duhet t'i tregoni e diskutoni në klasë.

8.10.49. Në **Afrikën e Jugut** eksiton një sistem i kombinuar i gjyqësisë kushtetuese. Në kuadër të palëve të autorizuara hyn edhe individi, i cili mund të ngre çështje të caktuara kushtetuese. Përshkruani juridiksionin e **GJKAJ**, që e bën këtë vend t'i takojë sistemit të përzier të gjyqësisë kushtetuese dhe, në të njëjtën kohë, tregoni se çka nënkuptohet me çështje kushtetuese të cilat mund t'i ngre një individ pranë saj?

8.10.50. Vendet frankofone të **Afrikës** do të duhej, krejt natyrshëm, të modeloheshin sipas sistemit francez. Kjo për faktin se kanë qenë koloni franceze përgjatë shekujve. Ky, megjithatë, nuk është rasti.

Pas pavarësimit të tyre, këto vende ndoqën një rruge krejt ndryshe nga shteti metropol. Kjo gjendje ka zgjatur deri në mbarimin e **Luftës së Ftohtë**. Pas kësaj kohe, vendet në fjalë kanë ndjekur një rrugë tjetër të zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese. Për çfarë bëhet fjalë? Diskutoni kohën pas fitimit të pavarësisë së këtyre vendeve! Për se këto vende nuk përqafuan modelin francez të gjyqësisë kushtetuese dhe cilin model e përqafuan pas mbarimit të **Luftës së Ftohtë**? Tregoni në veçanti arsyet e këtij zhvillimi specifik të vendeve **frankofone,** duke i krahasuar këto vende me vendet anglofone, ku gjyqësia kushtetuese pak a shumë ka qenë dhe ngelet e modeluar sipas sistemit britanik.

8.11. Lexim shtesë

- Tom Ginsburg, *Judicial Rveiw in New Democracies. Constituional Courts in Asian States* (Cambridge University Press: Cambridge, 2003)
- Vicki C. Jackson and Mark Tushnet, *Comparative Constitutional Law* (Foundation Press: New York NY, 2006)
- Hans-Georg Heinrich and Ludmilla Lobova (eds.), *Legal Systems in Transition: A Comparison of Seven Post-Soviet Countries* (Peter Lang GmbH: Frankfurt am Main, 2006)
- Tom Ginsburg, "Constitutional Courts in East Asia: Understanding Variation" *Journal of Comparative Law* Volume 3 Issue 2 (2008)
- Andreë Harding and Peter Leyland, "The Constitutional Courts of Thailand and Indonesia: Two Case Studies from South East Asia" *Journal of Comparative Law* Volume 3 Issue 2 (2008)
- Zhenis Kembayev, *Constitutional Law of the Republic of Kazakhstan* (Academpress: Ukraine, 2014)
- Rosalin Dixon and Tom Ginsberg (eds.), *Comparative Constitutional Law in Asia* (Edward Elgar Publishing Limited: United Kingdom, 2014)
- Altangerel Byambajargal, *A Study on the Problems and Improvement of Constitutional Review in Mongolia*. Graduate School of Kookmin University. Department of Law and Major of Law (2014). A Dissertation for the Degree of Ph.D. Në internet: http://kookmin. dcollection.net/common/orgView/000002065932 (shikuar në korrik 2017)
- Wen Chen Chang,"The Constitutional Court of Taiwan." Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* (Cambridge University Press: Cambridge, 2017)
- Roman Petrov and Peter Van Elsuwege (eds.)*, Post-Soviet Constitutions and Challenges of Regional Integration: Adapting to European and Eurasian Integration Project*s (Routledge Research in EU Law) (Routledge: United Kingdom, 2018)

9. KOMISIONI I VENECIAS: KRIJIMI,QËLLIMET DHE RËNDËSIA E TIJ

Përgjithësisht. - Ky organ është themeluar në mbyllje të **Luftës së Ftohtë,** pas rrënimit të komunizmit në vitin 1990, në një kohë kur Evropa Lindore, apo Evropa ish-komuniste po shkundej nga terrori e dhuna komuniste gati gjysmëshekullore. Themelimi i tij u bë përmes një rezolute të **Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës** (Komiteti). Emri i tij i plotë është **Komisioni Evropian për Demokraci Përmes Ligjit**, mirëpo shkurtimisht njihet si **Komisioni i Venecias** (Komisioni), për shkak të vendit ku mbahen mbledhjet e tij çdo tre muaj.[1] Në ndërkohë që mbledhjet plenare mbahen në Venedik në **Scuola Grande di San Giovanni Evangelista**, ku është vetë selia e Komisionit, sekretariati i tij gjendet në **Strasburg**, ku gjendet edhe selia e **Këshillit të Evropës** (KE).

Idenë për themelimin e Komisionit i pari e dha profesori me renome i të drejtës kushtetuese, italiani **La Pergola**. Ai ka theksuar bindjen se një demokraci e qëndrueshme mund të krijohet vetëm në një kuadër të fortë kushtetues që bazohet në sundim të ligjit.[2] Kjo thënie në njëfarë mënyre paraqet misionin e vetë Komisionit.

Komisioni paraqet aktualisht njërin ndër organizmat kryesorë evropianë me rol udhëheqës në çështjet juridike dhe kushtetuese. Ai iu ofron këshilla dhe ekspertizë vendeve anëtare dhe jo anëtare të KE-së, organizatave ndërqeveritare dhe trupave tjerë shtetërorë dhe publikë në këto tri fusha:

- institucionet demokratike dhe të drejtat e njeriut;
- gjyqësia kushtetuese dhe gjyqësia e rregullt; dhe
- zgjedhjet, referendumet dhe partitë politike.

Në anëtarësinë e Komisionit hyjnë dyzetë e shtatë (47) shtete anëtare të KE-së, plus 14 shtetet joanëtare (**Algjeria, Brazili, Izraeli, Kazakistani, Republika e Koresë, Kosova, Kili, Kosta Rika Kirgistani, Maroku, Meksiko, Peru, ShBA** dhe **Tunizia**), si dhe partnerët institucionalë të Komisionit siç janë, ta zëmë, **Bashkimi Evropian** (BE) dhe **Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë** (OSBE).

Në fillim, Komisioni ka përfshirë një grup fare të vogël të shteteve sepse shumica e anëtarëve të KE-së kishin frikë se ky organizëm i ri do të ndërhynte në punët e brendshme dhe në sferën sovrane të shteteve anëtare. Kjo është arsyeja pse në fillim, kur është formuar Komisioni, u mor vesh, në kuadër të **KE**-së, një gjë e tillë është bërë në bazë të një marrëveshjeje, e njohur si e ashtuquajtura marrëveshje parciale (**Partial Agreement**). Për lidhjen e një marrëveshjeje të tillë,

---

1 Në fillim, jo të gjitha shtetet kanë qenë të mendimit se duhej formuar Komisioni. Një pjesë e tyre kishin frikë se Komisioni mund të shndërrohej në një mekanizëm ndërhyrës në punët e brendshme të shteteve, në veçanti në balancimin dhe kontrollin e pushtetit presidencial dhe pushtetit të parlamentit, si dhe në proliferimin e gjykatave kushtetuese si mekanizma të rinj që mund të zinin vendin e gjykatave supreme nacionale. Nga tetëmbëdhjetë shtete anëtare të **KE**-së në atë kohë, vetëm tetëmbëdhjetë u deklaruan në favor të themelimit të këtij organi kaq me rëndësi për zhvillimin e të drejtës kushtetuese nacionale dhe transnacionale në **Evropë** dhe më gjerë. Cf. Rudolf Schnutz Durr, "The Venice Commission". Në Tanja E.J. Kleinsorge (ed.), *Council of Europe* (Alphen aan den Rijn: The Netherlands, 2010) fq. 151-163 në fq. 153

2 Ibid. fq. 152.

vendet e para anëtare të Komisionit është dashur të kërkojnë miratim nga Komiteti.[3] Pa u bërë një vit, interesimi për t'u anëtarësuar në Komision tejkaloi gjeografinë e Evropës: shumë vende joevropiane dhe jo anëtare të KE-së shprehën interesimin e tyre për të qenë anëtarë të tij me të drejta të plota. Për t'u arritur kjo, së pari duhej ndryshuar natyra juridike e **Marrëveshjes Parciale**, gjë që nënkuptonte që kjo të transformohej në një marrëveshje të ashtuquajtur të zgjeruar (**Enlarged Agreement**).[4] Kjo u bë më datën 21 shkurt të vitit 2002, kur Komiteti në mbledhjen e vet të 784 miratoi Rezolutën (2002) 3 për **Revidimin e Statutit të Komisionit të Venecias.**[5] Pranimi i **Kosovës** në Komision është bërë mbi bazën e këtij ndryshimi statutor, bazuar në **Marrëveshjen e Zgjeruar**.

Sipas Statutit, secili vend dërgon në Komision një ekspert të pavarur. Ekspertët veprojnë në cilësi individuale dhe nuk mund të marrin asnjë udhëzim nga shteti dërgues.[6] Si anëtarë mund të jenë, siç u tha më lartë edhe vendet që nuk janë anëtare të KE-së.[7] Një rast i tillë është **Kosova**: autori i këtij libri është emëruar për herë të parë si përfaqësues i Kosovës me të drejta të plota në Komision më datën 12 shtator 2014, ani pse Kosova nuk është anëtare e KE-së.[8] Kjo do të thotë se anëtarësimi në Komision nuk lidhet me anëtarësimin në KE, siç është rasti me **Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut** (**GJEDNJ**), ku një vend nuk mund të jetë anëtar i kësaj të fundit pa qenë anëtar i organit të parë. Gjeografia e Komisionit është shumë më e gjerë se Evropa sepse përfshin edhe vendet jashtë kontinentit të vjetër.

Si përfaqësues në Komision zakonisht zgjidhen profesorët universitarë nga lëmi i të drejtës publike apo profesorët e të drejtës ndërkombëtare, kryetarët dhe gjyqtarët e gjykatave kushtetuese apo të gjykatave supreme, anëtarët e dikurshëm të parlamenteve nacionale dhe kështu me radhë. Mandati i tyre zgjatë katër vite dhe mund të përtërihet. Puna në Komision është pa pagesë, përveç rasteve kur bëhet angazhimi në ndonjë ekspertizë apo në ndonjë prej trupave të Komisionit: shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit, si dhe shpenzimet tjera për anëtarët e Komisionit barten nga ana e vetë shteteve dërguese.[9]

Komisioni njihet nga shumë aktivitete që bën, konferenca, kongrese, tryeza dhe seminare shkencore që organizon, por mendimet dhe raportet juridike si dhe studimet e veçanta janë ato që i japin vulë identitare këtij organi, si një organ këshillëdhënës në çështjet juridike dhe kushtetuese për vendet anëtare dhe jo anëtare si dhe për organizatat dhe trupat tjerë ndërkombëtarë. Kërkesën për mendim juridik zakonisht e paraqesin qeveritë e shteteve, mirëpo një gjë të tillë mund ta bëjnë

---

3 Marrëveshja Parciale është krijuar në konferencën themeluese të Komisionit, mbajtur më 19 dhe 20 janar 1990, kurse më 23 prill 1990 Komiteti, në mënyrë unanime, ka autorizuar krijimin e kësaj marrëveshjeje. Statuti i Komisionit është miratuar më 10 maj 1990 nga Komiteti. Nga njëzet e tri (23) vendet anëtare, sa ka pasur KE atëherë, vetëm tetëmbëdhjetë (18) syresh kanë miratuar marrëveshje parciale. Këto vende fillestare që kanë themeluar Komisionin janë si vijon: Austria, Belgjika, Danimarka, Greqia, Finlanda, Franca, Irlanda, Italia, Luksemburgu, Malta, Norvegjia, Portugalia, San Marino, Spanja, Suedia, Qipro, Turqia dhe Zvicra. Ibid. fq. 153-154.

4 Ibid. fq. 154.

5 Statute: Resolution (2002) 3. *Revised Statute of the European Commission for Democracy through Law* (adopted by the Committee of Ministers on 21 February 2002 at the 784th meeting of the Ministers' Deputies). Në internet: http://www.venice.coe.int/WebForms/pages/?p=01_01_Statute (shikuar në korrik 2017)

6 Neni 2.1 i Statutit të Komisionit.

7 Neni 2.5 i Statutit. Vendet joanëtare, megjithatë, nuk kanë të drejtë të votojnë për çështjet që ngriten nga trupat statutarë të KE-së. Kjo përcaktohet me nenin 5.2 të Statutit.

8 Cf. Letra e Ministrit të Jashtëm të Republikës së Kosovës e datës 12 shtator 2014, Ref. 547/14, drejtuar Sekretariat të Përgjithshëm të Komisionit, zt. **Thorbjorn Jagland**, me të cilin njofton për emërimin e prof. dr. **Enver Hasani**, atëherë kryetar i **Gjykatës Kushtetuese**, si përfaqësues i parë i **Kosovës** me të drejta të plota dhe të barabarta në Komision. Kjo letër është bërë në përgjigje të vendimit të datës 11 qershor 2014 të Komitetit, me të cilin **Kosova** ftohej që të bëhet anëtare e barabartë dhe me të drejta të plota e Komisionit; Cf po ashtu edhe "Kosovo becomes 60th member of Venice Commission of Council of Europe". *The Voice of Russia* 13 June 2014. Në internet: https://sputniknews.com/voiceofrussia/news/2014_06_13/Kosovo-becomes-60th-member-of-Venice Commission-of-Council-of-Europe-3883 (shikuar në korrik 2017).asani, wshtw wHasani, mmm

9 Neni 6.4 i Statutit të Komisionit.

edhe gjykatat kushtetuese, parlamentet, avokatët e popullit, si dhe organet përkatëse të KE-së, BE-së, OSBE-së, e kështu me radhë. Në praktikë, ndërkaq, janë organet e KE-së ato që kanë më së shumti kërkesa të paraqitura në Komision për dhënien e mendimeve juridike apo kryerjen e studimeve lidhur me çështjet konkrete juridike dhe kushtetuese.[10]

Mendimet, raportet juridike dhe studimet e veçanta mund t'i referohen çështjeve individuale që kanë lindur brenda shteteve sovrane dhe të pavarura. Ato, po ashtu, mund të kenë për objekt edhe çështjet transnacionale të natyrës kushtetuese, ndërkombëtare dhe të ngjashme. Në një rast të tillë, aktiviteti i Komisionit ka të bëjë me, ta zëmë, dhënien e mendimeve apo raporteve që kanë lidhen me kushtetutshmërinë e draft-kushtetutave nacionale, amendamenteve kushtetuese, draft-ligjeve dhe amendamenteve të tyre dhe kështu me radhë. Në veçanti, në lëmin e kushtetutëbërjes, Komisioni ka një rekord jashtëzakonisht pozitiv me shumë suksese sepse ka ndihmuar në draftimin e thuajse të gjitha kushtetutave të ish-vendeve komuniste të Evropës dhe më gjerë.[11] Në këto raste, aktiviteti ka konsistuar në dhënien e mendimeve dhe raporteve me objekt tema të natyrës transnacionale (siç janë mendimet, studimet apo raportet lidhur me sistemet zgjedhore, vetëvendosjen, natyrën e amendamentimit kushtetues, refugjatët, e kështu me radhë). Me kalimin e kohës, aktiviteti Komisionit është fokusuar në përpjekjet për ndërtimin dhe kultivimin e një **trashëgimie të përbashkët kushtetuese të vendeve evropiane** dhe më gjerë që bazohet në parimet themelore të KE-së, të cilat kanë të bëjnë me demokracinë, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit.[12]

Mendimet dhe raportet juridike të Komisionit nuk kanë fuqi detyruese. Në praktikë, megjithatë, në pjesën dërrmuese të rasteve, shtetet i zbatojnë ato me përpikëri. Për më tepër, vlen të theksohet se edhe **GJEDNJ**, jo rrallë, në vendimet e saj i citon mendimet juridike të Komisionit të shprehura në një rast konkret lidhur me një çështje konkrete.[13]

Të shohim tani si duket aktiviteti i Komisionit sipas fushave ku zhvillohet, të përmendura si më sipër. Pra, në seksionin e parë flasim për institucionet demokratike dhe të drejtat e njeriut, në të dytin për gjyqësinë kushtetuese dhe gjyqësinë e rregullt dhe, në të tretin, për zgjedhjet, referendumet dhe partitë politike. Sikundër shihet, këtu kemi vetëm katër seksione që diskutojmë temën bazë, në ndërkohë që seksioni i katërt i dedikohet komenteve dhe pyetjeve. Në seksionin e fundit jepet një literaturë shtesë që ndihmon lexuesin për të zgjeruar njohuritë e tij për Komisionin dhe çështjet që lidhen me të.

9.1. Institucionet demokratike dhe të drejtat e njeriut

Në kuadër të kësaj fushe përfshihen aktivitetet e Komisionit që kanë formën e mendimeve dhe raporteve juridike, studimeve të veçanta, tryezave, kongreseve, konferencave dhe seminareve shkencore në lëmenjtë si vijon:

- reformat kushtetuese;
- të drejtat themelore;
- institucioneve shtetërore;
- reformat në gjyqësor; dhe
- avokatinë e popullit

---

10 Rudolf Schnutz Durr, "The Venice Commission", fq. 151.

11 Cf. Paul Craig, "Transnational Constitution-Making: The Contribution of the Venice Commission on Law and Democracy". *UC Irvine Journal of International, Transnational, and Comparative Law* Vol. 2 (2017), fq. 57-86 në fq. 68-75.

12 Rudolf Schnutz Durr, "The Venice Commission", fq. 152; Maartije de Visser, *Constitutional Review in Europe. A Comparative Analysis* (HART Publishiung: Ocford and Portland Oregon, 2015) fq. 397.

13 Në mbi nëntëdhjetë vendime të saj që nga vitit 2002 e deri më sot, **GJEDNJ** ka cituar mendimet juridike të Komisoinit. **Cf.** *The Venice Commission of the Council of Europe.* **Në internet:** http://www.venice. coe.int/WebForms/ pages /?p=01_Presentation&lang=EN **(shikuar në shtator 2017).**

Detyra kryesore e Komisionit konsiston në dhënien e ndihmës dhe këshillave shteteve, në lëmin kushtetues dhe legjislativ, gjithnjë me qëllim të sigurimit të funksionimit demokratik të institucioneve shtetërore dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Në këtë lëmi, mendimet e Komisionit, konferencat, studimet dhe publikimet kapin tërë reformat kushtetuese dhe aspektet e tjera konkrete kushtetuese, siç janë: kontrolli dhe balancimi i pushteteve dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre, bashkëpunimi ndërinstitucional, sundimi i ligjit, reformat në gjyqësi, mbrojtja e të drejtave themelore, mbrojtja e pakicave, autorizimet në gjendje të jashtëzakonshme, imuniteti parlamentar, Avokati i Popullit, roli i pushtetit jashtë institucional, decentralizimi, federalizmi dhe regjionalizmi dhe, së fundi, çështjet që kanë të bëjnë me të drejtën ndërkombëtare.

Në fokus të punës së Komisionit që nga themelimi, ka qenë çështja e reformave kushtetuese. Në fakt, vetë Komisioni është themeluar pas rënies së Murit të Berlinit me qëllim që t'iu ofrojë ndihmë vendeve ish-komuniste të Evropës në procesin e refomimi të tyre kushtetues sipas parimeve, normave dhe standardeve të vendeve të demokracive kushtetuese liberale. Këto reforma kanë të bëjnë me vënien e themeleve të shtetit demokratik, kurse ndihma e Komisionit në këtë aspekt kryesisht vjen në formë të mendimeve, të cilat i jep në bazë të kërkesës së vetë shteteve të interesuara për një gjë të tillë. Kjo kërkesë mund të vijë edhe nga organet e KE-së, siç janë Asambleja Parlamentare, Komiteti, Kongresi i Autoriteteve Regjionale dhe Lokale dhe, së fundi, nga Sekretari i Përgjithshëm i KE-së. Kërkesa po ashtu mund të vijë edhe nga organizatat e organet tjera ndërkombëtare që marrin pjesë në aktivitetet e Komisionit.

Mendimet janë analitike dhe përmbajnë rekomandime në tekstin ekzistues të draft-kushtetutave, amendamenteve kushtetuese apo në draft-legjislacionin tjetër nga lëmi e të drejtës kushtetuese të vendeve kërkuese. Në këtë drejtim, Komisioni ka dhënë një kontribut të çmueshëm në zhvillimin e të drejtës kushtetuese, kryesisht, por jo ekskluzivisht, në demokracitë e reja të Evropës ish-komuniste.

Përveç sa më sipër, Komisioni ka dhënë një kontribut të çmueshëm në afrimin dhe ngritjen e garancioneve kushtetuese dhe ligjore në lëmin e mbrojtjes së të **drejtave dhe lirive themelore**. Këto përpjekje të Komisionit kanë synuar dhe synojnë që mbrojtja e lirive dhe të drejtave themelore të bëhet sipas standardeve ndërkombëtare dhe evropiane, në veçanti sipas standardeve të **Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut** (KEDNJ) dhe praktikës gjyqësore të **GJEDNJ**.

Në punën e vet të deritanishme, Komisioni ka shqyrtuar, **inter alia**, dispozitat kushtetuese dhe ligjore të vendeve anëtare që kanë të bëjnë me lirinë e mendimit, të ndërgjegjes dhe religjionit, lirinë e shprehjes dhe të informimit, lirinë e tubimit dhe asocimit, të drejtën për respektim të jetës private, si dhe ato që kanë të bëjnë me të drejtat e pakicave dhe të drejtat tjera që lidhen me mosdiskriminim.

Përveç ofrimit të këshillave dhe ndihmës vendeve individuale në lidhje me legjislacionin nacional të zakonshëm dhe atë me natyrë kushtetuese, Komisioni ka ofruar dhe ofron **studime më të thella në çështjet e lirive dhe të drejtave themelore.** Në këtë kontekst, ai ka miratuar udhëzime gjithëpërfshirëse që kanë të bëjnë me praktikat e ligjvënies dhe rregullimin (normimin) e standardeve përkatëse për të drejtat dhe liritë e caktuara (specifike), siç janë liritë fetare, liria e mendimit dhe e shprehjes, e drejta për të zgjedhur dhe për referendum, të drejtat e pakicave, e kështu me radhë. Këto studime zakonisht janë bërë dhe bëhen në bashkëpunim me **Zyrën për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut të Organizatës për Siguri** dhe **Bashkëpunim në Evropë** (**OSBE/ODIHR**) dhe shërbejnë si një mjet shtesë për ligjvënësit nacionalë, autoritetet publike, gjyqësorin, avokatët dhe palët tjera të interesuara që janë të përfshira në nivel nacional në mbrojtjen dhe implementimin e dispozitave ligjore dhe kushtetuese mbi mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore.

Në **lëmin institucional**, mendimet dhe raportet e Komisionit fokusohen në funksionimin e institucioneve politike, balancin dhe marrëdhëniet në mes të tri organeve të pushtetit shtetëror, përgjegjësitë e tyre, bashkëpunimin dhe kontrollin reciprok ndërmjet tyre dhe kështu me radhë. Puna në lëmin e institucione-

ve demokratike përfshin po ashtu ndihmën që iu ofrohet autoriteteve shtetërore për sa i përket kuadrit ligjor dhe institucional të **sistemit nacional gjyqësor** dhe reformat e këtij sistemi.

Puna e Komisionit shtrihet gjithashtu edhe ndaj çështjeve që kanë të bëjnë me kuadrin ligjor për funksionimin e **institucionit të Avokatit të Popullit** në shtetet anëtare. Komisioni pa ndërprerë dhe në mënyrë permanente ka avokuar për themelimin e institucionit të Avokatit të Popullit dhe forcimit të tij, duke e futur në gjirin e kategorive, organeve dhe institucioneve kushtetuese. Si rezultat i këtij angazhimi, thuajse nuk ekziston një kushtetutë e vendeve anëtare që nuk ka normuar me dispozita të saj pavarësinë organizative, institucionale dhe financiare të Avokatit të Popullit, duke i njohur këtij institucioni kompetenca mjaft të gjëra.

9.2. Gjyqësia kushtetuese dhe gjyqësia e rregullt

Që nga themelimi në vitin tanimë të largët 1990, Komisioni ka konsideruar se bashkëpunimi me gjykatat kushtetuese dhe gjykatat e tjera që ushtrojnë funksione të barasvlershme me gjykatat kushtetuese, është thelbësor për promovimin e konstitucionalizmit, i kuptuar ky si një ide sipas së cilës çdo veprim shtetëror duhet të ndërmerret brenda kufijve të përcaktuar me kushtetutë. Me qëllim të vënies në jetë të këtij postulati themelor të konstitucionalizmit modern, mekanizimi i gjyqësisë kushtetuese zë një vend të veçantë: gjykatat kushtetuese dhe trupat e barasvlershëm me to (këshillat kushtetues dhe gjykatat supreme që ushtrojnë juridiksion të njëjtë me gjykatat kushtetuese) janë të një rëndësie parësore në sigurimin se të gjitha degët e pushtetit respektojnë kushtetutën dhe se pushteti i dalë nga vota e popullit ushtrohet në bazë të kushtetutës.

Komisioni në vijimësi ka bërë përpjekje për të forcuar gjykatat kushtetuese dhe trupat e barasvlershëm me to (këshillat kushtetues dhe gjykatat supreme që ushtrojnë juridiksion të njëjtë me gjykatat kushtetuese) duke ofruar shërbime të ndryshme për to, si dhe duke i mbështetur të njëjtat në rastet kur vihet në siklet si pasojë e presionit të pavend të ushtruar ndaj tyre nga ana e organeve politike të pushtetit vendor. Ky bashkëpunim nxitet dhe drejtohet nga ana **Këshillit të Përbashkët të Gjyqësisë Kushtetuese** (**Këshilli i Përbashkët**). Ky organ ka krijuar disa mjete, të cilat i ofron Komisioni me qëllim të këmbimit të informatave dhe fertilizimit të tërthortë në mes të gjykatave. Këto mjete janë **Buletini i Praktikës Gjyqësore Kushtetuese** (**Buletin on Constitutional Case-Law**), e ashtuquajtura banka e të dhënave, e njohur si **CODICES** (**the CODICES database**) dhe, së fundi, **Forumi i Venecias** (**the Venice Forum**).

Me kërkesë të gjykatave kushtetuese apo trupave tjerë të barasvlershëm me to (këshillat kushtetues dhe gjykatat supreme që ushtrojnë juridiksion të njëjtë me gjykatat kushtetuese), Komisioni jep edhe **amicus curiae***,* të cilat kanë ndihmuar shumë në zhvillimin dhe promovimin e gjyqësisë kushtetuese si një mekanizëm i rëndësishëm në demokracitë e reja kushtetuese.

Në ndërkohë që, në thelb, Komisioni është një institucion evropian, disa nga këto shërbime, në veçanti **CODICES** dhe **Forumi i Venecias**, shtrihen edhe ndaj vendeve jo anëtare. Komisioni bashkëpunon ngushtë me gjykatat kushtetuese regjionale apo me gjykatat që bazohen në gjuhë të caktuara (gjykatat kushtetuese evropiane, afrikane, afrikano-jugore, aziatike, ibero-amerikane, demokracitë e reja, arabe, frankofone, portugez-folëse dhe, së fundi, gjykatat kushtetuese apo gjykatat e barasvlershëm me to nga vendet e komonveltit, përkatësisht nga vendet e sistemit **common law** apo **të drejtës së përgjithshme**). Bashkëpunimi me këto grupe është rritur dhe ka marrë formën e **Konferencës Botërore mbi Gjyqësinë Kushtetuese (Konferenca Botërore)**, në të cilin organizëm Komisioni luan rolin e Sekretariatit të Konferencës Botërore.[14]

[14] Kjo konferencës mbahet çdo tre vjet. E treta e këtij lloji është mbajtur në **Vilnius** të **Lituanisë** nga data 11 deri më datën 14 shtator 2017, ku autori i këtij libri ka marrë pjesë si përfaqësues i Komisionit. Temë e kësaj konference ka qenë **Sundimi i Ligjit dhe Gjyqësia Kushtetuese në Botën Moderne**, ku me kumtesa dhe paraqitje të tyre kanë dhënë kontribut të çmueshëm kryetarët dhe gjyqtarët e gjykatave kushtetuese dhe të trupave tjerë të barasvlefshëm me to, profesorë dhe shkencëtarë të së drejtës publike dhe të së drejtës ndërkombëtare, studiues dhe punëtorë tjerë të lëmit të gjyqësisë kushtetuese.

Me qëllim të nxitjes dhe promovimit të bashkëpunimit në mes të gjykatave kushtetuese dhe Komisionit, ky i fundit ka krijuar **Këshillin e Përbashkët.** Ky organ përbëhet nga anëtarët e Komisionit dhe oficerët e ndërlidhjes. Këta të fundit, oficerët e ndërlidhjes, caktohen nga ana e gjykatave kushtetuese. Këshilli ka presidencë të dyfishtë, që nënkupton se takimet e tij bashkëkryesohen. Njëri nga kryesuesit është anëtar i Komisionit, i zgjedhur nga vetë Komisioni në mbledhjen e vet plenare kurse tjetri është oficeri i ndërlidhjes, i zgjedhur nga oficerët e ndërlidhjes gjatë takimit të **Këshillit të Përbashkët**. Mandati i bashkëkryesuesve zgjat dy vjet për secilin prej tyre. Ky model kryesimi tregon se gjykatat kushtetuese dhe trupat tjerë të barasvlefshëm me to (këshillat kushtetuese apo gjykatat supreme që ushtrojnë juridiksion kushtetuese) kanë një ndikim të madh në përcaktimin e axhendës së këtij organi të Komisionit në çështjet që kanë të bëjnë me gjyqësinë kushtetuese.

Në aspektin gjeografik, **Këshilli i Përbashkët** përfshin shtetet anëtare të tij, shtetet me status të asocuar dhe të vëzhguesit si dhe entitetet me status special bashkëpunimi që është i barasvlefshëm me atë të vendeve vëzhguese (Afrika e Jugut, Autoriteti Nacional i Palestinës). Në kuadër të **Këshillit të Përbashkët**, të gjitha gjykatat, si ato të vendeve anëtare ashtu dhe gjykatat e vendeve vëzhguesve, përfitojnë nga lloji i njëjtë i bashkëpunimit. Po ashtu, marrin pjesë në punimet e tij edhe **GJEDNJ,** Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian (**GJDBE**) dhe Gjykata Ndëramerikane e të Drejtave të Njeriut (**GJNADNJ**).

Takimet e Këshillit të zakonisht fokusohen në publikimin e **Buletinit**, në prodhimin e bankës së të dhënave **CODICES** dhe të **Forumit** (që ka tri trajta: trajtën klasike, trajtën si grup i lajmeve dhe, së fundi, trajtën si observator), si dhe në bashkëpunimin me gjykatat kushtetuese dhe me **Konferencën Botërore**. Takimet zakonisht përcillen nga një minikonferencë lidhur me ndonjë temë në fushën e gjyqësisë kushtetuese, e cila përzgjidhet nga ana e oficerëve të ndërlidhjes. Gjatë minikonferencës, këta oficerë prezantojnë praktikën gjyqësore relevante të gjykatave të tyre kushtetuese (apo të këshillave kushtetuese dhe gjykatave supreme si trupa të barasvlefshme që ushtrojnë juridiksion në fushën e gjyqësisë kushtetuese). Të kësaj natyre janë, ta zëmë, temat siç janë siguria, ksenofobia të drejtat themelore dhe roli i gjykatave kushtetuese, të drejtat e komunitetit **LGBT**, diskriminimi dhe shkaqet e tij dhe kështu me radhë.

Këshilli takohet një herë në vit, me kërkesë të gjykatave pjesëmarrëse. Çdo tre vjet takohet në **Venedik**, qoftë para apo pas seancës së radhës plenare të Komisionit.

Buletini për herë të parë ka nisur të botohet në janar të vitit 1993. Në të përmbahen përmbledhjet (**précis**) e vendimeve më të rëndësishme të dërguara nga gjykatat kushtetuese apo nga trupat e barasvlefshëm me to (këshillat gjyqësore dhe gjykatat supreme me juridiksion kushtetutës në gjyqësinë kushtetuese) që marrin pjesë në Këshill. Botohet tri herë në vit në gjuhën angleze dhe frënge (gjuhët zyrtare të Komisionit).

Secili **Buletin** përmban aktgjykimet më të rëndësishme të dhëna nga gjykatat kushtetuese apo trupat tjerë të barasvlefshëm me to (këshillat kushtetuese dhe gjykatat supreme të mandatuara me kushtetutë për dhënien e gjyqësisë kushtetuese). Kontributet në Buletin dërgohen nga oficerët e ndërlidhjes të cilët, siç u tha, caktohen nga vetë gjykatat vendore kushtetuese apo trupat tjerë të barasvlerëshëm me to si më sipër.

Botimet e rregullta të Buletinit plotësohen nga seritë e buletineve speciale që përmbajnë përshkrimet e gjykatave dhe praktikën më të rëndësishme gjyqësore në sferën e tematikave më specifike, zakonisht të përpiluara sipas kërkesës së **Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane** (**Konferenca Evropiane**). Një seri tjetër e Buletinit para vitit 1993 përmban vendimet kryesore të gjykatave anëtare para nisjes së botimit të tij.

Qëllimi themelor i botimit të Buletinit është inkurajimi i këmbimit të informatave në mes të gjykatave dhe ndihma gjyqtarëve në zgjidhjen e çështjeve të ndjeshme kushtetuese, të cilat zakonisht janë çështje të ndjeshme edhe në vendet tjera anëtare të Komisionit. Përveç kësaj, botimi i tij është një mjet i dobishëm për akademikë dhe studiues të gjyqësisë kushtetuese. Nga dialogu në mes të gjykatave përmes Buletinit,

përfitojnë si gjykatat e reja ashtu edhe ato që kanë traditë të gjatë kushtetuese. Këto të fundit përfitojnë sepse janë gjykatat e reja ato që hasin në çështje kushtetuese me një tematikë të vjetër, por që kërkojnë zbatim të metodave dhe teknikave të reja të zgjidhjes së tyre.

Kosova që nga vitit 2014, kur u anëtarësua në **Komisionin e Venecias**, rregullisht dërgon përmbledhjen e vendimeve kryesore të Gjykatës Kushtetuese, të cilat përzgjidhen nga këshilltarët ligjorë të Gjykatës. Ato dërgohen në Komision përmes oficerit ndërlidhës, i caktuar po atë vit nga ana e kryetarit të Gjykatës, autorit të parë të këtij libri.

Banka e të dhënave, **CODICES**, përmban përmbledhjet dhe tekste të plota të përmbi 9,000 vendimeve, kryesisht në gjuhën angleze dhe frënge, por edhe në më shumë së në dyzetë gjuhë të tjera. Të gjithë buletinët janë po ashtu të përfshirë në këtë bankë të të dhënave, siç janë kushtetutat dhe ligjet mbi gjykatat kushtetuese. Banka përditësohet në mënyrë të rregullt me qëllim të paraqitjes së praktikës më të re gjyqësore.[15] Praktika gjyqësore dhe tekstet e kushtetutave dhe ligjeve mbi gjykatat kushtetuese janë të indeksuara,[16] ndërkohë që edhe vetë Këshilli rregullisht e përditëson **Thesaurus**-in, duke futur në te përvojën më të re në gjyqësinë kushtetuese. **Thesaurus**-i bën të mundur hulumtimin e bankës sipas temave specifike, siç janë liria e shprehjes, gjykimi i drejtë dhe i paanshëm, kompetencat e shefit të shtetit, sundimi i ligjit, e kështu me radhë.

Banka lehtëson në masë të madhe hulumtimin krahasimor të cilin e kryejnë gjykatat, në veçanti kur flitet për qasjet e përbashkëta të gjykatave në sferën e të drejtave themelore. Qarkullimi i informatave paraqet një mjet të fuqishëm të fertilizimit të ndërsjellë të gjykatave, duke mundësuar që ato të modelohen dhe inspirohen në vendimmarrjen e tyre nga përvojat kushtetuese të vendeve të tjera. Në ndërkohë që gjykatat, zakonisht, nuk u referohen përvojave të huaja, argumentet që marrin nga **CODICES** pasurojnë aktgjykimet e tyre.

Sikundër u tha në fillim, detyra kryesore e Komisionit, që nga themelimi i tij, ka qenë dhe ngelet ofrimi i këshillave juridike anëtarëve të vet të cilët dëshirojnë dhe synojnë që të sjellin sistemet dhe strukturat e tyre institucionale, juridike dhe kushtetuese në harmoni me standardet evropiane dhe praktikën më të mirë ndërkombëtare në lëmin e demokracisë, të drejtat e njeriut dhe sundim të ligjit. Kjo ndihmë juridike ofrohet në formë të mendimeve juridike lidhur me draft-legjislacionin apo legjislacionin që është në fuqi, përfshirë këtu kushtetutat dhe amendamentet kushtetuese.

Në rastet kur kërkesat e shteteve anëtare janë paraqitur nga gjykatat kushtetuese nacionale apo trupat me juridiksion të barasvlefshëm në lëmin e gjyqësisë kushtetuese (këshillat kushtetuese dhe gjykatat supreme) si dhe nga ana e GjEDNj, atëherë mendimet e Komisionit quhen **amicus curiae**.

Një **amicus curiae** i hartuar nga Komisioni ofron informacion lidhur me çështjet e të drejtës kushtetuese krahasuese dhe të drejtës ndërkombëtare. Kjo nënkupton se me këtë rast nuk adresohet kushtetutshmëria e një akti juridik apo ligji, për të cilin kërkohet mendimi i Komisionit në formën e **amicus curiae**. Në këtë kontekst, vlen të theksohet fuqishëm këtu se, roli i Komisionit nuk është që të adresojë rastet specifike dhe as të bëjë vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitave të brendshme të vendit nga vjen gjykata që kërkon **amicus curiae.** Këto janë role që i takojnë gjykatave nacionale. Kjo është arsyeja që Komisioni çdoherë kërkon nga gjykatat nacionale që të specifikojnë shumë qartë si dhe të formulojnë si duhet dhe në mënyrë të saktë pyetjet apo pyetjen për të cilën (apo për të cilat) ato dëshirojnë të marrin një përgjigje nga Komisioni.

Në përvojën e Komisionit ka pasur dhe ka me qindra raste të dhënies së **amicus curiae** sipas kërkesës së gjykatave dhe palëve tjera të autorizuara, duke u dhënë atyre një përgjigje në çështjet e caktuara dhe

[15] Veb faqja e bankës së të dhënave **CODICES** është kjo: www.CODICES.coe.int

[16] Praktika gjyqësore si dhe tekstet e kushtetutave dhe të ligjeve mbi gjykatat janë të sistemuara sipas indeksit **Systematic Thesaurus**.

specifike, me të cilat ato ndeshen gjatë punën së tyre.[17] Mendimet **amicus curiae** kanë për qëllim që gjykatave kërkuese t'u ofrojnë një perspektivë krahasuese dhe ndërkombëtare, por në fund duke ua lënë vetë gjykatave të tilla vendimmarrjen përfundimtare lidhur me atë nëse është kushtetues ligji akti tjetër juridik.[18]

Në vijim sa më sipër, ne do të përmendim vetëm një rast, nga qindra sosh, rastin e **Moldavisë**, si një prej shumë shembujve, i cili është rast tipik që ndihmon lexuesin për të parë si duket një **amicus curiae**.[19]

Pranë **Gjykatës Kushtetuese të Moldavisë** (GJKMo) ka qenë duke u gjykuar rasti lidhur me nenin 27 të **Ligjit nr. 151 të Moldavisë mbi Agjentin e Qeverisë**. Sipas këtij ligji, qeveria ka pasur të drejtë që të padisë individët, përfshirë këtu gjyqtarët e të gjitha llojeve të gjykatave vendore, për shkak se veprimet apo mosveprimet e tyre kanë shkaktuar apo kanë kontribuar në masë të madhe në shkeljet e dispozitave të **KEDNJ**, të cilat janë vërtetuar qoftë me një aktgjykim të **GJEDNJ**, me një pajtim gjyqësor të imponuar ndaj Shtetit të **Moldavisë** apo përmes një deklarate të imponuar ndaj qeverisë së tij.

GJKMo ka dhënë aktgjykimin për këtë rast më 25 korrik 2016, duke marrë parasysh rekomandimet e Komisionit, të shprehura në një **amicus curiae** që diskutohet në vijim. Ajo ka konstatuar se e drejta e shtetit për padi si më sipër, nuk është në vetvete kundër kushtetuese për aq sa të jetë e garantuar pavarësia e gjyqtarëve. Kjo nga shkaku se, kjo e fundit përbën një parakusht të domosdoshëm për sundimin e ligjit dhe një garancion të domosdoshëm për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Në vijim të kësaj, **GJKMo** gjeti se neni 27 tejkalon kuadrin e përgjitshhëm për përgjegjësinë e gjyqtarëve sepse nuk kërkon ekzistimin e një vendimi gjyqësor vendor të dhënë në një gjykim të ndarë ku konstatohet faji individual por bazohet në mënyrë ekskluzive në aktgjykimin e **GJEDNJ**. Për këtë arsye, **GJKMo** shpalli nenin 27 si kushtetues vetëm në rastet kur padia e shtetit ka për bazë një aktgjykim të dhënë në një procedurë të ndarë gjyqësore në nivel nacional, me të cilën konstatimi i fajësisë individuale të gjyqtarit ka ndodhur si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të qëllimshme, të cilat si të tilla kanë kontribuar në shkeljen e dispozitave të **KEDNJ.** Ky aktgjykim, që është bazuar në tërësi në **amicus curiae** të Komisionit, konstaton se çdo padi shtetërore që nuk bazohet në një vendim të një gjykate vendore të dhënë në procedurë të veçantë ku konstatohet fajësia e gjyqtarit individual përbën ushtrim arbitrar të pushtetit shtetëror dhe prishje të pavarësisë së gjyqësorit nacional.

---

17 Rastet e tjera të **amicus curiae** të dhëna nga Komisioni viteve të fundit janë si vijon: "*Amicus curiae* brief for the Constitutional Court of **Albania** on the Law for the temporary re-evaluation of Judges and Prosecutors (Vetting Law)", adopted by the Venice Commission in December 2016. Në internet: http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2016)036-e (shikuar në shtator 2017); "*Amicus curiae* brief for the Constitutional Court of **Bosnia and Herzegovina** on the mode of election of delegates in the House of Peoples of the Parliament of the Federation of Bosnia and Herzegovina", adopted by the Venice Commission in October 2016. Në internet: http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2016)024-e (shikuar në shtator 2017); *Amicus curiae* brief for the Constitutional Court of **Albania** on the restitution of property, adopted by the Venice Commission in October 2016. Në internet: http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2016)023-e (shikuar në shtaor 2017); "*Amicus curiae* brief for the Constitutional Court of **Georgia** on the *non ultra petita* rule in criminal cases", adopted by the Venice Commission in June 2015. Në internet: http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2015)016-e (shikaur në shtator 2017); "*Amicus curiae* brief in the case of **Rywin v. Poland** (Applications Nos 6091/06, 4047/07, 4070/07) **before the European Court of Human Rights** (on Parliamentary Committees of inquiry)", adopted by the Venice Commission in March 2014. Në internet: http://www. venice.coe.int/webforms/ documents/?pdf=CDL-AD(2014)013-e (shikuar në shtator 2017).

18 Maartije de Visser, *Constitutional Review in Europe. A Comparative Analysis*, fq. 398.

19 EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION), *REPUBLIC OF MOLDOVA AMICUS CURIAE BRIEF FOR THE CONSTITUTIONAL COURT ON THE RIGHT OF RECOURSE BY THE STATE AGAINST JUDGES* (Article 27 of the Law on Government Agent no.151 of 30 July 2015). Adopted by the Venice Commission at its 107th Plenary Session (Venice, 10-11 June 2016) on the basis of comments by Mr Sergio BARTOLE (Substitute member, Italy) Mr Johan HIRSCHFELDT (Substitute member, Sëeden) Mr Eirik HOLMØYVIK (Substitute member, Norway) Mr Gunars KŪTRIS (Substitute member, Latvia) Ms Grainne McMORROW (Substitute member, Ireland. *Opinion No. 847 / 2016 CDL-AD (2016)015 Or. Engl).* Strasbourg, 13 June 2016; Cf. këtë rast si dhe rastet tjera të **amicus curiae brief** të dhëna nga Komisioni në doracakun: EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION), *COOPERATION WITH COINSTITUTIONAL COURTS* (Council of Europe: Starsbourg, August 2017) fq. 11-12.

Në fund të këtij seksioni, shënojmë se aktivitet jo më pak i rëndësishëm i Komisionit në lëmin e gjyqësisë kushtetuese janë edhe seminaret dhe konferencat e tij të zhvilluara me gjykatat kushtetuese nacionale (apo me trupat tjerë të barasvlefshëm në lëmin e gjyqësisë kushtetuese). Në përgjigje të kërkesave të një numri të gjykatave kushtetuese, Komisioni ka organizuar një sërë aktivitetesh me këto gjykata. Që nga vitit 1996, konferenca dhe seminare janë mbajtur në këto vende: **Afrikë e Jugut, Armen, Azerbajxhan, Bosnje dhe Hercegovinë, Estoni, Francë, Gjeorgji, Kirgistan, Kroaci, Latvi, Lituani, Moldavi, Poloni, Rumani, Rusi, Sllovaki dhe Ukrainë.**[20] Këto seminare dhe konferenca kanë mbuluar jo vetëm çështjet nga praktika, siç janë buxhetimi dhe menaxhimi i gjykatave dhe marrëdhëniet e tyre me publikun, por edhe tema që kanë të bëjnë me parimet themelore demokratike, siç janë ndarja dhe balancimi i pushteteve dhe pavarësia e gjyqësorit të rregullt.

9.3. Zgjedhjet, referendumet dhe partitë politike.

Komisioni që nga themelimi ka qenë mjaft aktiv edhe në lëmin e zgjedhjeve, në veçanti përmes miratimit të mendimeve lidhur me draft-legjislacionin për zgjedhjet të vendeve të ndryshme. Përgjatë dy dekadave ka miratuar më shumë se 130 mendime dhe mbi 60 tekste lidhur me zgjedhjet, referendumet dhe partitë politike[21].

Në këtë aspekt, Komisioni bashkëpunon ngushtë me **OSBE/ODIHR**. Në të shumtën e rasteve mendimet lidhur me legjislacionin zgjedhor përpilohen së bashku nga këto dy institucione.

Ndër vendet që kanë bashkëpunuar rregullisht dhe ngushtë me Komisionin në lëmin e zgjedhjeve mund të citohen si vijon: **Armenia, Bullgaria, Gjeorgjia, Moldavia, Shqipëria** dhe **Ukraina**. Komisioni ka qenë aktiv edhe në shtetet tjera, siç janë: **Britania e Madhe, Maqedonia, Meksika, Kroacia, Rusia, Serbia, kantonet zvicerane**, **Kirgistani dhe Uzbekistani.**

Përgjatë viteve 2016-2017, Komisioni ka adresuar draft-legjislacionin për zgjedhjet, referendumet dhe partitë politike në këto vende: **Armeni, Bosnje dhe Hercegovinë, Bullgari, Gjeorgji, Moldavi, Maqedoni** dhe **Ukrainë.**

Komisioni po ashtu punon edhe në çështjet që kanë të bëjnë me **referendumet**, si për sa i përket aspekteve të tyre të përgjithshme ashtu edhe kur bëhet fjalë për segmente të veçanta të institucionit të referendumit. Kështu, ta zëmë, Komisioni ka qenë i përfshirë në referendumin për pavarësi të **Malit të Zi** në vitin 2006 dhe, së fundi, në referendumin e provincës autonome italiane të **Trentos**.

Me qëllim që ligjeve zgjedhore t'u jepet një stabilitet dhe të ndërtohet një trashëgimi evropiane në lëmin e zgjedhjeve, Komisioni dhe **Këshilli për Zgjedhjet Demokratike** (**Këshilli për Zgjedhjet**) kanë draftuar parimet e trashëgimisë elektorale evropiane. Këto parime gjenden të ravijëzuara në veçanti në **Kodin e Praktikave të Mira në Çështjet e Zgjedhjeve** (**Kodin për Zgjedhjet**) dhe në **Kodin e Praktikave të Mira në Referendume** (**Kodin për Referendumet**). Këto dy tekste janë dokumente referencë të KE-së. Ato janë miratuar nga **Asambleja Parlamentare** (**Asambleja**) dhe **Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Regjionale** (**Kongresi**) të KE-së, si dhe gëzojnë përkrahjen e Komitetit.

Një herë në vit, Komisioni organizon **Konferencën Evropiane të Trupave Elektorale** (**Konferenca Elektorale**) si dhe seminare komparative. Në vitin 2016, ai ka lansuar Debatin e Parë Shkencor Elektoral, së bashku me Autoritetin Permanent Elektoral të **Rumanisë** (i barasvlefshëm me **Komision Qendror të Zgjedhjeve në Kosovë**). Komisioni, në këtë drejtim, ka përgjegjësi për të mbajtur sesione trajnimi për komisionet qendrore zgjedhore dhe për gjyqtarët e involvuar në gjykimin e kontesteve elektorale, në zg-

[20] Për të dhënat nga veb faqja e Komisionit, cf. burimet në internet: http://www. venice.coe.int /WebForms /pages/?p=01_ Constitutional_Justice&lang=EN (shikuar në shtator 2017).

[21] Për të dhënat nga web faqja e Komisionit të Venecias, cf. burimet në internet: http://www.venice.coe.int/ WebForms/ pages/?p=01_ Elections_ and_ Referendums&lang=EN (shikuar në shtator 2017).

jidhjen e çështjeve të tjera ligjore dhe për të ndihmuar profesionalisht te njëjtit. Në këtë lëmi, Komisioni ofron ndihmë edhe për misionet vëzhguese të cilat Asambleja i dërgon nëpër vende të ndryshme të botës. Kështu, në vitin 2016, Komisioni ka marrë pjesë në nëntë misione vëzhguese në këto vende: **Bjellorusi, Bullgari, Gjeorgji, Jordan, Moroko, Maqedoni, Mali i Zi** dhe **Serbi.**

Është **Këshilli për Zgjedhjet** ai që qeveris me punën e Komisionit në lëmin e zgjedhjeve. Ky organ përbëhet nga tri palë: përfaqësuesit e Komisionit, të Asamblesë dhe të Kongresit.

Këshilli për Zgjedhjet ka për detyrë të bëjë analizën e mendimeve dhe studimeve të kryera nga ana e Komisionit para se ato të shkojnë në mbledhjen plenare të tij për miratim. Qëllimi i punës është që të shërbejë si një ndërmjetës në mes të Komisionit si organ juridik dhe Asamblesë e Kongresit të KE-së si organe politike që janë në ngarkesë të monitorimit të zgjedhjeve, në mënyrë që të mundësohet krijimi i disa standardeve të përbashkëta për zgjedhjet. Kjo vlen në veçanti për **Evropën,** ku synohet krijimi i një trashëgimie të përbashkët evropiane në fushën e zgjedhjeve, sikundër edhe në çdo fushë tjetër që ka të bëjë me ndërtimin e institucioneve demokratike të qeverisjes.

Aktivitetet e Komisionit në lëmin e zgjedhjeve kanë të bëjnë me si vijon:

- dhënia e mendimeve dhe studimet;
- organizimin e seminareve, punëtorive trajnuese dhe misioneve të ndihmës;
- ndërtimin e bankës së dhënave, e njohur si **VOTA;**[22] dhe, së fundi
- përpilimin e teksteve (doracakëve) që kanë të bëjnë me partitë politike

Mendimet dhe studimet në lëmin e zgjedhjeve mbulojnë tri aspekte. I pari aspekt është ai i përgjithshëm, ku Komisioni merret me analizimin dhe studimin e temave të përgjithshme lidhur me zgjedhjet.[23]

Në këtë kuadër Komisioni ka përpiluar **Kodin për Zgjedhjet** dhe **Kodin për Referendumet.** Krahas kësaj, Komisioni ka kryer studime krahasuese, siç janë, ta zëmë, studimet krahasuese të referendumeve në **Evropë** dhe studimet tjera që lidhen me kufizimin e të drejtës së votës nëpër legjislacionet nacionale dhe sipas **KEDNJ**.

Komisioni, po ashtu ka bërë raportime lidhur me rregullat zgjedhore dhe veprimin afirmativ për pjesëmarrjen e pakicave kombëtare në procesin e vendimmarrjes në vendet evropiane, një raport tjetër mbi sistemet proporcionale me lista të hapura dhe lista të mbyllura, si dhe një tjetër që përmban udhëzime për pengimin dhe kundërvënien ndaj shpërdorimit të burimeve administrative gjatë procesit zgjedhor.

Përveç sa më sipër, temat tjera të përgjithshme që ka studiuar dhe për të cilat Komisioni ka dhënë mendime dhe raportime kanë të bëjnë pragun zgjedhor, kufizimin e mandateve si dhe votimin elektronik dhe votimin nga distanca.

Komisioni në mënyrë të rregullt miraton mendime në lëmin zgjedhor dhe të referendumeve. Deri më tani ka miratuar mbi 130 sosh. Gjatë viteve 2016 – 2017 ka miratuar mendime lidhur me legjislacionin mbi zgjedhjet, referendumet dhe partitë politike në **Armeni**, **Bosnje dhe Hercegovinë**, **Bullgari**, **Gjeorgji, Maqedoni, Moldavi** dhe **Ukrainë**. Në vitin 2015 Komisioni ka adresuar e çështjen e referendumit të provincës autonome italiane të **Trento**s.

---

[22] Banka e të dhënave **VOTA** mundëson qasjen në legjislacionin elektoral dhe në dispozitat relevante kushtetuese të të gjithë anëtarëve të Komisionit të Venecias, vendeve vëzhguese dhe shteteve tjera që marrin pjesë në punën e Komisionit. Në **VOTA** po ashtu gjenden edhe dokumentet bazë, mendimet dhe studimet e kryera në lëmin e zgjedhjeve. Këto janë në gjuhën angleze, frënge apo spanjolle. Përveç kësaj, **VOTA** ofron një mjet shtesë në formë të **Systematic Thesaurus**, në mënyrë që të mundësohet hulumtimi në bankën e të dhënave sipas tematikës specifike, siç janë, ta zëmë, sistemet zgjedhore apo financimi i zgjedhjeve. **VOTA** është themeluar nga ana e Sekretariatit të Komisionit të Venecias dhe mbahet në bashkëpunim me Tribunalin Meksikan Zgjedhor të Gjyqësorit Federal (TEPJF). Cf. për veb faqen e VOTA në internet: http://vota.te.gob.mx/ (shikuan në tetor 2017).

[23] Cf. më shumë për këtë në vebfaqen e **Këshillit për Zgjedhjet Demokratike** në internet: http://www. venice.coe.int/WebForms/pages/?p=02_Opinions_and_studies (shikuar në tetor 2017).

Në shumicën e rasteve këto mendime përpilohen bashkërisht me OSCE/ODIHR.

Në këto mendime, Komisioni zakonisht nënvizon tri elemente që e bëjnë një sistem zgjedhor të suksesshëm:

- legjislacioni duhet të jetë i qartë, gjithëpërfshirës, sipas standardeve ndërkombëtare dhe që adreson rekomandimet paraprake;
- legjislacioni duhet të miratohet me një konsensus të gjerë pas konsultimeve të gjëra dhe të thella publike më të gjitha palët e interesuara; dhe
- zotimi politik për zbatim të tërësishëm dhe me mirëbesim të legjislacionit për zgjedhjet.

Aspekti i dytë i Komisionit në lëmin e zgjedhjeve është specifik dhe tematik. Ai ka të bëjë me pakicat kombëtare dhe procesin zgjedhor.

Në kuadër të pjesëmarrjes në jetën publike të personave që i takojnë pakicave kombëtare, Komisioni ka miratuar një dokument që titullohet **E Drejta Zgjedhore dhe Pakicat Kombëtare**. Ky dokument nënvizon se vetëm disa shtete kanë rregulla specifike lidhur me përfaqësimin e pakicave në trupat e zgjedhur. Pozicioni i Komisionit ka qenë dhe është se pjesëmarrja e pakicave në jetën publike nuk rezulton nga zbatimi i rregullave specifike për pakicat, por nga zbatimi i rregullave të përgjithshme zgjedhore të cilat duhet të përshtaten në atë mënyrë që të rrisin shanset e pakicave për sukses të kandidatëve të tyre.

Kjo pozitë e Komisionit ka ardhur si rezultat i analizës së rregullave specifike që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e pakicave në jetën publike. Kjo analizë është reflektuar në dy dokumente:

- raportin mbi rregullat zgjedhore dhe veprimin afirmativ për pjesëmarrjen e pakicave në vendimmarrjen në vendet evropiane; dhe
- raportin mbi votimin e dyfishtë për personat që u takojnë pakicave kombëtare.

Raporti i parë tregon se një numër i shteteve kanë rregulla interesante zgjedhore që përmbajnë synime për arritjen e qëllimit të veprimit afirmativ dhe se, në shumicën e këtyre shteteve, këto rregulla janë një rast i izoluar. Përveç kësaj, rregullat zgjedhore që promovojnë veprimin afirmativ në përgjithësi kanë caqe të kufizuara, në veçanti kur flitet për numrin e saktë të përfituesve të përcaktuar me kushtetutë apo me legjislacion të rregullt. Rregullat e tilla duket se janë në veçanti efektive në zgjedhjet lokale. Përkundër natyrës kundërthënëse të veprimit afirmativ, sot ekzistojnë mekanizma të shumtë të veprimit afirmativ në sferën zgjedhore që janë në harmoni më trashëgiminë evropiane zgjedhore.

Raporti i dytë konstaton se votimi i dyfishtë përbën një përjashtim.[24] Si i tillë, ai duhet të parashikohet me kushtetutë dhe mund të lejohet vetëm nëse respekton aspektet e ndryshme të parimit të proporcionalitetit. Kjo nënkupton se votimi i dyfishtë është i arsyeshëm vetëm nëse:

- nuk është e mundur që të arrihet qëllimi përmes masave më pak kufizuese të cilat nuk ndërhyjnë në të drejtat e barabarta të votimit;
- ka karakter kalimtar; dhe
- ka të bëjë me një pakicë të vogël.

Aspekti i tretë dhe i fundit në kuadër të aktivitetit të Komisionit në lëmin e zgjedhjeve, po ashtu është tematik dhe specifik. Si i tillë ka të bëjë me barazinë gjinore dhe zgjedhjet.[25]

Në **Deklaratën mbi Pjesëmarrjen e Grave në Zgjedhje (Deklarata)**, Komisoni ka theksuar se zbatimi i parimit të paritetit mund të rezultojë në:

- sistem zgjedhor sipas listës ku ekziston detyrimi për të futur në listë një femër dhe një mashkull

[24] Ibid. po aty.

[25] Ibid. po aty.

në mënyrë të njëpasnjëshme dhe ku refuzohet regjistrimi i listave të kandidatëve që nuk respektojnë një detyrim të tillë; dhe

- sistem zgjedhor me një zonë zgjedhore ku ekziston detyrimi i respektimit të një përqindjeje të balansuar në mes të femrave dhe meshkujve në kuadër të kandidatëve nga e njëjta parti, si dhe sanksione përkatëse për mosrespektim të një detyrimi të tillë.

Deklarata është pasuar nga **Raporti mbi Ndikimin e Sistemeve Zgjedhore në Përfaqësimin e Femrave në Politikë (Raporti**). Ky raport konkludon se ekzistojnë një seri faktorësh të natyrës socio-ekonomike, kulturore dhe politike që mund të pengojnë ose të lehtësojnë pjesëmarrjen e femrës në parlament. Sistemi zgjedhor dhe kuotat gjinore përbëjnë instrumentet më të fuqishme për përfaqësimin e femrave në parlament. Ky raport më tutje elaboron modalitetet e sigurimit të barazisë gjinore në kontekste të ndryshme socio-politike dhe kulturore.

9.4. Komente dhe pyetje

9.4.1. Për Komisionin janë shkruar me mijëra faqe, artikuj, studime dhe libra. Janë mbajtur me qindra seminare e konferenca. Një kapitull i një libri si ky yni nuk mjafton për të thënë krejt çfarë duhet thënë e ditur lidhur me këtë trup evropian këshillëdhënës me ndikim të jashtëzakonshëm në transformimin e vendeve ish-komuniste dhe diktatoriale në demokraci kushtetuese ku mbisundon ligji, demokracia dhe ekziston një respekt për të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve. Për cilat çështje Komisioni jep këshilla dhe si ka lindur formimi i tij? Mbi të gjitha, idetë janë fakte, prandaj ka rëndësi se kush e sajoi këtë fakt, pra kush e ka dhënë i pari idenë për formimin e Komisionit të Venecias?

9.4.2 Në fillim, Komisioni u themelua vetëm nga një grup i shteteve dhe me një gjeografi të kufizuar. Pse pati rezerva nga ana e shteteve për themelimin e Komisionit dhe të çfarë natyre ishin ato rezerva?

9.4.2. Komisioni ofron këshilla dhe ekspertizë vendeve anëtare dhe jo anëtare të KE-së, organizatave ndërqeveritare dhe trupave tjerë shtetërorë dhe publikë në tri fusha. Cilat janë ato tri fusha?

9.4.3. Kosova është anëtar i Komisionit të Venecias me të drejta të plota. Kur ka ndodhur kjo? Cila ka qenë baza juridike e pranimit të Kosovës në Komisionin e Venecias, pa qenë fare anëtar i Këshillit të Evropës?

9.4.4. Sipas Statutit të Komisionit të Venecias, secili shtet dërgon në Komision një ekspert të pavarur. Sa zgjat mandati i ekspertëve në Komision? Në çfarë cilësie veprojnë ekspertët? Cilit profesion zakonisht i takojnë ekspertët në fjalë?

9.4.5. Mendimet, raportet juridike dhe studimet e veçanta të Komisionit të Venecias mund t'i referohen çështjeve individuale në kuadër të shteteve sovrane dhe të pavarura. Po ashtu, ato mund të kenë për objekt edhe çështjet transnacionale të natyrës kushtetuese, ndërkombëtare dhe të ngjashme. Cilat janë çështjet individuale në kuadër të shteteve sovrane dhe të pavarura e cilat çështjet transnacionale të cilat janë objekt trajtimi nga Komisioni i Venecias në mendimet, raportet juridike dhe studimet e tij të veçanta?

9.4.6. Në fushën e institucioneve demokratike dhe të drejtat e njeriut, Komisioni ka zhvilluar një aktivitet të bujshëm dhe të dendur pafundësisht që nga themelimi i tij. Ky aktivitet përfshin disa aspekte. Për cilat aspekte bëhet fjalë këtu?

9.4.7. Në lëmin e të drejtës kushtetuese, Komisioni ka treguar një sukses të dukshëm dhe të matshëm. Për çfarë bëhet fjalë kryesisht?

9.4.8. Në lëmin e të drejtave të njeriut, Komisioni po ashtu ka një rekord të mirë të suksesit. Në çka konsiston ky sukses dhe cili organ tjetër ka qenë partner i Komisionit në realizimin e këtij suksesi në lëmin e të drejtave të njeriut?

9.4.9. Lëmi institucional, siç e tregon fjala, ka të bëjë me ndihmën e Komisionit në ndërtimin e institucioneve demokratike në vend. Si duket kjo?

9.4.10. I fundit aspekt ku Komisioni ka treguar sukses të madh, ka të bëjë më lëmin e Avokatit të Popullit. Në çka konsiston konkretisht ky sukses i Komisionit në sferën e jetës dhe punës së institucionit të Avokatit të Popullit?

9.4.11. Komisioni në vijimësi ka bërë përpjekje për të forcuar gjykatat kushtetuese dhe trupat e barasvlefshëm me to (këshillat kushtetues dhe gjykatat supreme që ushtrojnë juridiksion të njëjtë me gjykatat kushtetuese), duke ofruar shërbime të ndryshme për këto gjykata dhe trupa si dhe duke i mbështetur të njëjtat në rastet kur janë vënë në siklet si pasojë e presionit të pavend të ushtruar ndaj tyre nga ana e organeve politike të pushtetit vendor. Për të arritur këtë, Komisioni ka krijuar një organ të veçantë që nxitë dhe drejton bashkëpunimin në mes të gjykatave kushtetuese dhe trupave të barasvlefshëm me to (këshillat kushtetues dhe gjykatat supreme që ushtrojnë juridiksion të njëjtë me gjykatat kushtetuese). Si quhet ky organ, cili është qëllimi i tij dhe cilat mjete i ka në dispozicion për të arritur qëllimin e vet?

9.4.12. Buletini i Praktikës Gjyqësore Kushtetuese botohet një herë në vit. Kur ka nisur për herë të parë botimi i tij, çka përmban dhe cili është qëllimi i tij?

9.4.13. E njohur si **CODICES**, kjo bankë të dhënave ka një përmbajtje të caktuar. Në çka konsiston kjo përmbajtje dhe cilit qëllim i shërben? A i citojnë gjykatat kushtetuese vendore burimet që gjenden në **CODICES?**

9.4.14. Në rastet kur kërkesat e shteteve anëtare janë paraqitur nga gjykatat kushtetuese nacionale apo trupat me juridiksion të barasvlefshëm në lëmin e gjyqësisë kushtetuese (këshillat kushtetuese dhe gjykatat supreme) si dhe nga ana e GJEDNJ, atëherë mendimet e Komisionit quhen **amicus curiae**. Cilat çështje adresohen nga ana e Komisionit përmes **amicus curiae**?

9.4.15. Një **amicus curiae** i hartuar nga Komisioni ofron informacion lidhur me çështjet e të drejtës kushtetuese krahasuese dhe të drejtës ndërkombëtare. A nënkupton kjo se me **amicus curiae** adresohet kushtetutshmëria e një akti juridik apo ligji që mund të jetë kontestues në rastin e paraqitur për zgjidhje pranë gjykatës dhe që kërkon prononcimin e Komisionit në këtë formë, pra në formë të një **amicus curiae**?

9.4.16. Në këtë kontekst, tregoni a është roli i Komisionit që të adresojë rastet specifike që presin zgjidhje pranë gjykatës kërkuese të **amicus curiae** dhe të bëjë vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitave të brendshme të vendit nga vjen gjykata në fjalë?

9.4.17. Komisioni që nga themelimi ka qenë mjaft aktiv edhe në lëmin e zgjedhjeve, në veçanti përmes miratimit të mendimeve lidhur me draft-legjislacionin për zgjedhjet të vendeve të ndryshme: përgjatë dy dekadave ka miratuar më shumë se 130 mendime dhe mbi 60 tekste lidhur me zgjedhjet, referendumet dhe partitë politike. Në këtë aspekt, Komisioni bashkëpunon ngushtë me një organ të caktuar të OSBE-së. Për cilin organ është fjala dhe cilat janë aktivitetet e përbashkëta të Komisionit dhe këtij organi të OSBE-së?

9.4.18. Në kuadër të Komisionit ekziston një organ që quhet **Këshilli për Zgjedhjet Demokratike**. Cilat janë palët prej të cilave përbëhet ky organ dhe cilat janë aktivitetet kryesore të tij?

9.4.19. **Këshilli për Zgjedhjet** synon krijimin e një trashëgimie të qëndrueshme evropiane në lëmin e zgjedhjeve dhe referendumeve. Në këtij kontekst, Këshilli për Zgjedhjet ka përpiluar disa tekste që kanë relevancë të madhe në fushën e zgjedhjeve dhe referendumeve vendore. Këto tekste janë dokumente referencë të KE-së janë miratuar nga **Asambleja** dhe **Kongresi** të KE-së dhe janë përkrahur nga ana e **Komitetit**. Për cilat tekste bëhet fjalë këtu?

9.4.20. Sipas Komisionit të Venecias, ekzistojnë disa elemente që e bëjnë një sistem zgjedhor vendor të suksesshëm, përfshirë këtu edhe sigurimin e të drejtave të minoriteteve të të gjitha llojeve si dhe të drejtave të femrave për përfaqësim të barabartë dhe dinjitoz në jetën politike. Për këtë qëllim, Komisioni ka prodhuar disa dokumente që reflektojnë synimet si më sipër. Diskutoni përmbajtjen e këtyre dokumenteve të Komisionit?

9.5. Lexim shtesë

- Malinverni, Giorgio, *L'expérience de la Commission européenne pour la démocratie par le droit*, in: Flaus, Jean-François, *Vers un droit constitutionnel européen - Quel droit constitutionnel européen? Revue Universelle des Droits de l'Homme* Vol. 7 Nos. 4-6 (1995)
- Buquicchio, Gianni / Pierre Garrone, " L'harmonisation du droit constitutionnel européen: la contribution de la Commission européenne pour la démocratie par le droit". *UNIFORM LAW REVIEW/REVUE DE DROIT UNIFORME* Vol. III No. 2/3 (1998)
- Garrone, Pierre, "La commission de Venise à la veille de son 10e anniversaire". *Rivista di Studi politici internazionali*, 1999
- Gianni Buquicchio/ Pierre Garrone, "Vers un espace constitutionnel commun - Le rôle de la Commission de Venise". Në *Bruno Haller et al*. (*ed*.), *Law* in *Greater Europe – Towards* a *Common Legal* Area- Studies in *Honor* of *Heinrich Klebes* (*Kluëer Law International*, The *Hague*, *2000*)
- Alain Chablais / Pierre Garrone, "European Commission for Democracy through Law - Review of Recent Reports and Opinions Relevant to the Protection of National Minorities" *European Yearbook of Minority Issues,* Vol. 05 (2005/6)
- Pieter van Dijk, "The Venice Commission on certain aspects of the European Convention of Human Rights". Në Stephan Breitenmoser et al. (eds.), *Human Rights, Democracy and the Rule of Law - Menschenrechte, Demokratie und Rechtsstaat – Droits de l'homme, démocratie et Etat de droit. Liber amicorum Luzius Wildhaber* (Dike Verlag: Zürich/St. Gallen, 2007)
- Amaya Ubeda de Torres, "*La régionalisation par la coordination interétatique: le rôle catalyseur de la Commission de Venise"* Në Stéphane Doubé-Billé (ed.), *La régionalisation du droit international. Cahiers de droit international* (Bruylant Edition: Bruxelles, 2012)
- Gianni Buquicchio/ Simona Granata-Menghini, "The Venice Commission Twenty Years on. Challenge met but Challenges ahead". Në Marjolein van Roosmalen/ Ben Vermeulen/ Fried van Hoof/ Merten Oostling (eds.), *Fundamental Rights and Principles – Liber Amicorum Pieter van Dijk* (Intersentia: Cambridge, Antwerp, Portland 2013)
- Wolfgang Hoffmann-Riem, "The Venice Commission of the Council of Europe – Standards and Impact". *The European Journal of International Law* Vol. 25 No. 2 (2014)
- Sergio Bartole, "International Constitutionalism and Conditionality - the Experience of the Venice Commission" *Rivista AIC - Associazione Italiana dei Costituzionalisti*, 4/2014
- Maartje De Visser, "A Critical Assessment of the Role of the Venice Commission in Processes of Domestic Constitutional Reform " *American Journal of Comparative Law* Vol. 63 No. 4 (2015)
- Cesare Pinelli, "Parliaments, Constitutional Transitions and the Venice Commission". Report at the LUISS Summer School on "Parliamentary Democracy in Europe", LUISS, Rome, 23 July 2015
- Sergio BARTOLE, "THE EXPERIENCE OF THE VENICE COMMISSION: SOURCES AND MATERIALS OF ITS ELABORATION OF THE INTERNATIONAL CONSTITUTIONAL LAW". *THE EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION)*, Strasbourg, 14 December 2016 CDL-PI (2016) 016
- Hanna SUCHOCKA, "CONSTITUTIONAL HERITAGE AND THE FORM OF GOVERNMENT". *THE EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION),* Strasbourg, 15 December 2016 CDL-PI(2016)017
- Kaarlo Tuori, "From Copenhagen to Venice." Në Carlos Closa & Dimitry Kochenov (eds.) *Reinforcing Rule of Law Oversight in the European Union* (Cambridge University Press: Cambridge, 2016)
- Valentina Volpe, "Drafting Counter-majoritarian Democracy. The Venice Commission's Constitutional Assistance", *Heidelberg Journal for International Law, ZaöRV* Vol. 76 No. 4 (2016).

PJESA E DYTË

GJYQËSIA KUSHTETUESE NË KOSOVË

DERI NË FITIMIN E PAVARËSISË DHE PAS SAJ

10. DERI NË FITIMIN E PAVARËSISË

Përgjithësisht. - Gjyqësia kushtetuese kosovare para fitimit të pavarësisë ka ndjekur rrugën e zhvillimit të Kosovës, fillimisht si pjesë e ish-Jugosllavisë e më pastaj si entitet me një subjektivitet tmerrësisht të reduktuar kushtetues gjatë kohës së regjimit represiv të udhëhequr nga diktatori serb **Slobodan Milosheviq** nga viti 1986 deri në viti 2000. Në fakt, periudha nën sundimin e tij paraqet kohën ku as që mund të flitet për gjyqësi kushtetuese, si pasojë e integrimit të tërësishëm me dhunë të Kosovës në sistemin kushtetues serb.

Përveç kësaj rrethane, ekziston edhe një arsye tjetër pse imponohet nevoja e trajtimit të gjyqësisë kushtetuese në kuadër të trajtimit të historisë së përgjithshme politike dhe kushtetuese të Kosovës: përgjatë pjesës më të madhe të historisë së saj, **Kosova** nuk ka pasur një identitet kushtetues dhe territorial, lëre më një gjyqësi të veçantë kushtetuese. As në nivel jugosllav nuk ka pasur ndonjë traditë të madhe në gjyqësinë kushtetuese. Edhe atëherë kur gjyqësia kushtetuese u fut në sistemin kushtetues jugosllav, **Kosova** fitoi të drejtën për të qenë pjesë e saj nëntë vjet më vonë, në vitin 1972. Në këtë vit u themelua **Gjykata Kushtetuese e KSA e Kosovës (GJKKSAK).**

Gjendja si më sipër imponon detyrimin për të folur për historinë e të drejtës kushtetuese kosovare në përgjithësi, që ka qenë në fuqi në territorin tonë, sa kemi qenë pjesë integrale e ish-**Jugosllavisë** (1918-1992), me pastaj edhe si pjesë e **Serbisë** (1989-1999). Në këtë përfshihet edhe periudha e caktuar kur Kosova ka gëzuar një identitet të ndarë kushtetues dhe territorial, shumë të ngjashëm me ish-republikat jugosllave (1967-1989).[1]

Ish-Jugosllavia ka pasur disa emra kushtetues: nga themelimi i saj më 1918 e deri në vitin 1929 është quajtur **Mbretëria Serbo-Kroato-Sllovene** (Mbretëria SKS). Nga kjo kohë e deri në vitin 1943, ajo është quajtur **Mbretëria Jugosllave**. Në periudhën ndërmjet viteve 1943 - 1946 u quajt **Republika Federale Demokratike e Jugosllavisë** (RFDJ). Në vitin 1946 ka ndërruar emrin në **Republika Federale Popullore e Jugosllavisë** (RFPJ), të cilin emër e ka mbajtur deri në vitin 1963, kur ka marrë **Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë** (RSFJ), të cilin e ka mbajtur deri në shpërbërjen e saj në pranverë të vitit 1992. Në këtë vit është krijuar **RFJ** (Serbia dhe Mali i Zi) nga diktatori serb **Sllobodan Millosheviq**. Ky shtet, pra, është përbërë nga **Serbia** dhe **Mali i Zi**, në kuadër të së cilës ka qenë **Kosova**.

RFJ ka qenë njëri prej pesë shteteve të dala nga rrënimi i ish-**Jugosllavisë**, krahas **Bosnje-Hercegovinës**, **Kroacisë**, **Maqedonisë** dhe **Sllovenisë**. Me ish-**Jugosllavi**, sikundër mund të vërehet, nënkuptohet shteti që ka ekzistuar nga viti 1918 deri në vitin 1992: nga aspekti juridik-ndërkombëtar ka kontinuitet të plotë në mes të Jugosllavisë mbretërore dhe asaj socialiste. E thënë me fjalë të tjera, ai shtet është i njëjtë nga aspekti i të drejtës ndërkombëtare gjatë tërë asaj periudhe. Në aspektin kushtetues, ndërkaq, ai shtet disa herë ka pasur shkëputje dhe diskontinuitet radikal me të kaluarën, çështje që diskutohet në këtë kapitull dhe janë vijim i diskutimit tonë nga kapitulli i pestë i këtij libri.

Në pikëpamje kushtetuese, ish-**Jugosllavia** ka pasur një diskontinuitet të plotë për shkak të ndryshimeve që kanë ndodhur në vitin 1943-1946. Nga ky aspekt, pra nga aspekti i të drejtës kushtetuese, ky shtet në fazën e parë të zhvillimit të vet ka qenë me rregullim shtetëror mbretëror (1918-1946), kurse në të dytën me rregullim shtetëror socialist republikan (1946-1992). Në fazën e tretë bëhet fjalë për diskontinuitet ndërkombëtar dhe kushtetuese në mes të ish-Jugosllavisë dhe RFJ, krijesës së ndërtuar nga diktatori

[1] Për një trajtim të hollë dhe shumë te detajuar e me kompetencë të historisë politike, kushtetuese, ekonomike dhe kulturore të ish-Jugosllavisë përgjatë shekullit XX, cf. librin e autores gjermane Mari-Žanin Čalić, *Istorija Jugoslavije u XX veku* (Clio: Beograd, 2013) (në gjuhën serbe, alfabeti cirilik)

serb S. Millosheviq. Pas kësaj kohe, **Kosova** gjendet nën sovranitetin ekskluziv **RFJ** (1992-1999). Kjo krijesë shtetërore, në diskursin juridiko-politik dhe kushtetues serb cilësohet si **Jugosllavia e tretë**, për ta dalluar atë nga dy Jugosllavitë e mësipërme. Në këtë aspekt, pra në aspektin ndërkombëtar, përsërisim, Jugosllavia e krijuar në vitin 1918 ka ekzistuar deri në prill të vitit 1992. Ajo që serbët e quajnë **Jugosllavi e tretë** nuk është asgjë tjetër pos njëri prej pesë shteteve të reja që dolën nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë. Ato shtete të reja janë, sipas rendit alfabetik, si vijon: **Bosnje-Hercegovina, Kroacia, Sllovenia, Maqedonia** dhe **RFJ**. Kjo e fundit u riemërtua në Unioni Serbi-Mali i Zi (**USMZ**) deri në shpërbërjen e saj në vitin 2006: në qershor të këtij viti, **Mali i Zi**, si njëri nga dy shtetet e USMZ, u shkëput dhe fitoi pavarësinë e vet. Nga ky vit lind **Serbia** si shtet sovran dhe i pavarur, për herë të parë pas vitit 1918, kur, së bashku me Malin e Zi, ishte futur në **Mbretërinë SKS**.

Si pasojë e ndryshimeve revolucionare të vitit 1943 ka ardhur deri të ndryshimi rrënjësor i sistemit kushtetues jugosllav, duke u shndërruar gradualisht, deri në vitin 1946, një shtet komunist i tipit sovjetik. Nga aspekti i të drejtës kushtetuese, pas rënies së **Murit të Berlinit** dhe kolapsit të sistemit komunist, ka ardhur deri te ndryshimi i serishëm rrënjësor i sistemit kushtetues në territoret ish-jugosllave, përfshirë Republikën e **Serbisë**, siç kishte ndodhur në tërë **Evropën** ish-komuniste. Nga kjo kohë **RFJ**, si njëri prej pesë shteteve të reja të dala nga rrënojat e ish-Jugosllavisë, u transformua në një shtet pluralist në aspektin kushtetues.

Për dallim nga vendet tjera të **Evropës ish-**komuniste, **RFJ** pas vitit 1990, ani se u deklarua për barazi dhe liri të të gjithëve, morri rrugën e nacionalizmit ekstrem dhe violent duke sulmuar ushtarakisht popujt dhe republikat tjera të ish **Jugosllavisë** me armatimin, paratë dhe pasurinë e përbashkët që u krijua përgjatë kohës së ish-Jugosllavisë. Kjo pati për pasojë shkaktimin e luftërave dhe gjenocidit në **Bosnje-Hercegovinë**, **Kroaci** (1991-1995) dhe **Kosovë** (1998-1999).

Kosova ka dal si shteti i gjashtë, jo nga rrënojat e ish-Jugosllavisë: në aspektin ndërkombëtar, vendi ynë nuk është trashëgimtar (sukcesor) i ish-**Jugosllavisë** (1918-1992) por i **Republikës së Serbisë**, e krijuar si shtet i ri dhe i pavarur në qershor të vitit 2006, kur **Mali i Zi** u shkëput nga **USMZ.**

Siç e kemi shtjelluar në kapitullin e pestë të këtij libri, gjendja në aspektin ndërkombëtar të ish-**Jugosllavinë** dhe **RFJ** paraqitet ndryshe nga aspekti i saj kushtetues. Në aspektin juridik-ndërkombëtar, ish-**Jugosllavia** ka qenë një dhe e vetme dhe nuk paraqet kontinuitet shtetëror juridik-ndërkombëtar të **Mbretërisë së Serbisë** (1882-1918), siç nuk paraqet **RFJ**, e krijuar në pranverë të viti 1992, kontinuitet juridik-ndërkombëtar me ish-Jugosllavinë.

Si mbretëri, ish-Jugosllavia u themelua më 1 dhjetor 1918, me emrin **Mbretëria SKS,** nën udhëheqjen e dinastisë serbe të familjes **Karagjorgjeviq**. Më 6 janar 1929, mbreti **Aleksander Karagjorgjviq** shpërndau parlamentin jugosllav dhe shpalli diktaturën mbretërore. Me këtë rast erdhi vetëm deri te ndryshimi i emrit të saj kushtetues: tani e tutje, deri në shkatërrimin e saj në prill të vitit 1941, Mbretëria SKS u quajt **Mbretëria Jugosllave.** Ky emër u ndërrua me arsyetimin se shteti kishte nevojë për unitet ashtu që tani e tutje, sipas kurorës mbretërore, të gjithë ishin jugosllavë. Kjo bëri që, gjithnjë sipas arsyetimit zyrtar, më të mos ekzistonte **një komb me tre emra**, siç ishte menduar në dhjetor të vitit 1918, ku u krijua ai shtet. Kjo nuk nënkupton që para datës 6 janar 1929 ai shtet ka pasur strukturë administrativo-shtetërore që respekton diversitetin etnik, nacional, gjuhësor, fetar dhe tjetër: ndarjet administrativo-territoriale të tij gjatë tërë kohës kishin pasur për qëllim ndrydhjen dhe mohimin e diversiteteve etnike, nacionale, fetare dhe të tjera.[2]

Sikundër u konstatua më sipër, zhvillimi kushtetues i **Kosovës** ka qenë pjesë e zhvillimit kushtetues të ish-Jugosllavisë (1918-1992), përkatësisht **RFJ** (1992-2003) dhe **USMZ** (2003-2006). **RFJ** ka pasur

[2] "Uredba o podeli zemlje na oblasti". *Sluzbene Novine Kraljevine SHS* Br. 92 (26 april 1922). Për komentet, cf. Ana S. Trbovich, *A Legal Geography of Yugoslavia's Disintegration* (Oxford University Press: Oxford, 2008) (kapitulli i 3-të flitet gjerësisht për kufijt administrative të ish-Jugosllavisë (1918-1992) dhe për mosrespektimin e kritereve etnike dhe historike me rastin e caktimit të tyre, me përjashtim të rastit të **Banovinës Kroate** që u themelua në prag të Luftës së Dytë Botërore). Po ashtu, cf. edhe **Omer Hamzić, "**Ustavno određenje i realni odnosi između organa uprave i samouprave u prvoj deceniji Kraljevine SHS". *Gracanicki glasnik Broj 31 (maj 2011) fq. 36-49.*

sovranitet kushtetues dhe ndërkombëtar ndaj **Kosovës** vetëm deri me hyrjen e trupave të NATO-s në **Kosovë** më datën 10 qershor 1999. Nga kjo datë **Kosova** është vënë në administrim ndërkombëtar, që personifikohet me autoritetin e administratës së përkohshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), e njohur me shkurtesën **UNMIK**-ut. Pas kësaj, **Republika e Serbisë** ka nxjerrë disa akte me rëndësi kushtetuese, përfshirë këtu kushtetutën e saj të fundit të vitit 2006, aktualisht në fuqi. Kjo kushtetutë, në një mënyrë iluzore flet për **Kosovën** si pjesë të **Serbisë**, si një autonomi e saj substanciale. Këtë e kemi diskutuar në kapitullin e pestë, kur kemi folur për ish-**Jugosllavinë** dhe **RFJ**.

Në vijim flasim për dokumentet me karakter kushtetues të këtij vendi fqinjë të **Kosovës** dhe për rëndësinë e tyre aktuale, në një kohë që **Kosova** ka bërë mbi një dekadë nga shpallja e pavarësisë më 17 shkurt 2008. Kjo shpallje është njohur nga më shumë se gjysma e vendeve anëtare të OKB-së. Që nga futja e **Kosovës** nën sovranitetin jugosllav më 1 dhjetor 1918 e deri më sot, ekzistojnë disa dokumente me rëndësi kushtetuese, të cilat i diskutojmë në këtë kapitull për shkak të relevancës së tyre sa i përket gjyqësisë kushtetuese kosovare, origjinës dhe zhvillimit të saj. Ato dokumente janë si vijon:

- Akti i datës 1 dhjetor 1918[3]
- **Kushtetuta e Vidovdanit** e datës 28 qershor 1918[4]
- Ligji mbi pushtetin mbretëror dhe administratën supreme shtetërore i datës 6 janar 1929[5]
- Kushtetuta e dhuruar e datës 3 shtator 1931[6]
- Rezoluta mbi themelimin e **KAÇKJ** e datës 27 nëntor 1942[7]
- Deklarata e Mbledhjes së Dytë të **KACKJ** e datës 29 nëntor 1943[8]
- Marrëveshja e Beogradit **Tito Shubashic** e datës 1 nëntor 1944[9]
- Rezoluta e shpalljes së **KACKJ** si Kuvend i Përkohshëm Popullor Republikës Demokratike të Jugosllavisë[10]
- Deklarata mbi shpalljen e **RFPJ** e datës 29 nëntor 1945[11]
- **Kushtetuta e RFPJ** e datës 31 janar 1946[12]
- Ligji kushtetues mbi bazat e rregullimit shtetëror dhe politik të Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë dhe organet federative të pushtetit i datës 13 janar 1953[13]
- **Kushtetuta e RSFJ** e datës 7 prill 1963[14]

---

3 Për tekstin e plotë, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavnanavigacija/leksikon_jugoslavije/konstitutivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 nëntor 2017).

4 Për tekstin e plotë, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavnanavigacija/leksikon_jugoslavije/konstitutivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 nëntor 2017).

5 Për tekstin e plotë, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavnanavigacija/leksikon_ jugoslavije/konstitutivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 nëntor 2017).

6 Për tekstin e plotë, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavna_ navigacija/leksikon_ jugoslavije/konstitutivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 nëntor 2017).

7 Për tekstin e plotë, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavna_ navigacija/leksikon_ jugoslavije/konstitutivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 nëntor 2017).

8 Për tekstin e plotë, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavna_ navigacija/leksikon_ jugoslavije/konstitutivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 nëntor 2017).

9 Për tekstin e plotë, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavna_ navigacija/leksikon_ jugoslavije/konstitutivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 nëntor 2017).

10 Për tekstin e plotë, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavna_ navigacija/leksikon jugoslavije/konstitutivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 nëntor 2017).

11 Për tekstin e plotë, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavna_ navigacija/leksikon_ jugoslavije/konstitutivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 nëntor 2017).

12 Për tekstin e plotë, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavna_ navigacija/leksikon jugoslavije/konstitutivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 nëntor 2017).

13 Për tekstin e plotë, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavna_ navigacija/ leksikonjugoslavije/konstitutivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 nëntor 2017).

14 Për tekstin e plotë, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavna_ navigacija/ leksikonjugoslavije/konstitutivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 nëntor 2017).

- Amendamentet në Kushtetutën e RSFJ të vitit 1963[15]
- **Kushtetuta e RSFJ** e datës 21 shkurt 1974[16]
- Amendamentet në **Kushtetutën e RSFJ** të vitit 1974[17]
- **Kushtetuta e KSAK** e datës 28 shkurt 1974[18]
- Amendamentet në Kushtetutën e KSAK[19]
- **Kushtetuta e Kacanikut** e datës 2 shtator 1990[20]
- **Kushtetuta e RFJ** e datës 27 prill 1992[21]
- **Marrëveshja e Rambujesë** e shkurt-marsit 1999[22]
- **Rezoluta 1244** e OKB-së për Kosovën e datës 10 qershor 1999 dhe dokumentet tjera të nxjerra në bazë të saj, përfshirë këtu **Kornizën Kushtetutese për Vetqeverisje të Përkohshme në Kosovë,** datë 15 maj 2001[23]
- **Marrëveshja e Beogradit** dhe **Karta Kushtetuese** e USMZ[24]
- **Kushtetuta e Serbisë** e datës 30 shtator 2006[25]
- **Plani Ahtisari** i datës 2 shkurt 2007[26]
- **Kushtetuta** e vitit 2008.[27]

Ky kapitull ndahet në disa seksione në të cilat diskutohet zhvillimi kushtetues i **Kosovës** dhe i gjyqësisë së saj kushtetuese. Ato seksione përfshijnë kohën para dhe pas shpalljes së pavarësisë dhe kanë të bëjnë me:

- periudhën deri në nxjerrjen e **Kushtetutës së Kosovës** të vitit 1974, e cila përfshin edhe kohën para **Luftës së Dytë Botërore**, pra që nga nisja e sovranitetit jugosllav mbi Kosovën dhe shqiptarët nën ish Jugosllavi më datën 1 dhjetor 1918;
- periudhën pas vitit 1974 deri me ardhjen në pushtet të diktatorit serb **Sllobodan Milosheviq**, e cila përfshin kohën e rrënimit të autonomisë së Kosovës dhe të gjyqësisë së

---

15 Për tekstin e plotë, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavna_ navigacija/ leksikonjugoslavije/konstitutivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 nëntor 2017).

16 Për tekstin e plotë, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavna_ navigacija/leksikonjugoslavije/konstitutivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 nëntor 2017).

17 Për tekstin e plotë të amendamenteve, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavna navigacija/leksikonjugoslavije/konstitutivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 nëntor 2017); Për analizën e nisjes së krizës jugosllave dhe shkaqet e saj, cf. më shumë në Mari-Žanin Čalić, *ISTORIJA JUGOSLAVIJE U XX VEKU*, fq. 327-379.

18 **Kushtetuta e KSA të Kosovës**. *Gazeta Zyrtare e KSAK* nr. 4. Prishtinë, 27 shkurt 1974.

19 **Amendamentet XVIII-LV në Kushtetutën e KSAK**. *Gazeta Zyrtare e KSAK* nr. 24. Prishtinë, 10 korrik 1989

20 **Kushtetuta e Kacanikut, 7 shtator 1990.** Në internet: https://sq.wikibooks.org/wiki/I.Dispozitat_ep%C3%ABrg j ithshme

21 Për tekstin e plotë, shih në internet:http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavnanavigacija/ leksik onjug oslavije/konstitutivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 nëntor 2017).

22 **Rambouillet Accords: Interim Agreement for Peace and Self-Government in Kosovo**. *Letter dated 4 June 1999 from the Përmanent Representative of \france to the United Nations Adressed to the Secretary General.* Security Council S/1999/648. 7 June 1999. English. Original: French.

23 **Resolution 1244 (1999)**. *Adopted by the Security Council at its 4011th meeting, on 10 June 1999*. Security Council. S/RES/1244 (1999) 10 June 1999. Original: English. Në internet: https://documents-dds-ny.un.org/doc/ UN DOC /GEN/N99/172/89/PDF/N9917289.pdf?OpenElement(shikuarnë janar 2018); **Kornizë Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë** (15 maj 2001). Në internet: https://www.kuvendikosoves.org/ common/ docs/ FrameëorkPocket_ALB_Dec2002.pdf (shikuar në janar 2018).

24 **Sporazum o principima odnosa Srbije i Crne Gore u okviru drzavne zajednice** (14 mart 2002)**. Në internet:** http://www.montenet.org/2002/osnove.html (shikuar në janar 2018); **Ustavna povelja drzavne zajednice Srbija I Crna Gora** (4 februar 2003) *Službeni list Srbije i Crne Gore*, br. 1/2003. Në internet: http://mojustav.rs/wp-content/uploads/2013/04/ustavna_ povelja _ scg. pdf (shikuar në janar 2018)

25 **Ustav Republike Srbije.** Në internet: http://www.ius.bg.ac.rs/prof/materijali/martan /UstavSrbije.pdf (shikuar në janar 2018).

26 **Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës 2 shkurt 2007.** Në internet: https:/ / www.kuvendikosoves.org/common/docs/Propozim%20për%20Statusin%20e%20Kosoves.pdf (shikuar në janar 2018)

27 **Kushtetuta e Republikës së Kosovës.** Në internet: http://www.kushtetutakosoves.info/ repository /docs/ Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf (shikuar në janar 2018).

saj kushtetuese, luftën paqësore dhe luftën e armatosur të shqiptarëve të Kosovës kundër regjimit represiv millosheviqian, **Konferencën e Rambujesë** dhe dokumentin shumë interesant dhe me një rëndësi të fortë për historinë kushtetuese dhe ndërkombëtare të Kosovës të miratuar në konferencë dhe, së fundi, vënien e Kosovës nën administrim ndërkombëtar të **OKB-**së; dhe, së fundi,

- periudhën nën administrimin ndërkombëtar të **UNMIK**-ut dhe shpalljen e pavarësisë së Kosovës, e cila përfshin kohën e hartimit të dizajnit aktual kushtetues që modelohet sipas sistemit **evropian/kelzenian** si pasojë e formës dhe përmbajtjes së demokracisë kushtetuese kosovare të sanksionuar me **Kushtetutën e Republikës së Kosovës**, në fuqi nga 15 qershori i vitit 2008. Kjo kushtetutë është miratuar nga **Kuvendi i Kosovës** më 9 prill 2008 dhe u draftua nën ndikimin vendimtar të vendeve perëndimore dhe ekspertëve të **Komisionit të Venecias**. (Kushtetuta e vitit 2008 ose vetëm "Kushtetuta")

Në të gjitha diskutimet e këtij kapitulli fokusi ngelet tek zhvillimi kushtetues i **Kosovës**, përfshirë këtu vetë momentin e formimit të gjyqësisë kushtetuese kosovare në vitin 1972, gjë që nënkupton përfshirjen e periudhave si më sipër deri te shpallja e pavarësisë së **Kosovës**. Në të gjitha këto diskutime komentohen tekstet kushtetuese bazike që kanë të bëjnë me ish-**Jugosllavinë**, **Kosovën** dhe, për aq sa ka nevojë, **Republikën e Serbisë**. Kjo rrugë ndiqet këtu meqenëse në kapitujt në vijim flitet më gjerësisht për **GJKRKS**, e themeluar në aspektin formal në janar të vitit 2009, por që në mënyrë efektive ka nisur punën e saj në shtator të po atij viti.[28]

Në aspektin socio-politik, Kosova paraqet një vend ish komunist në tranzicion. Tranzicioni në Kosovë, megjithatë, ka filluar njëzet vjet më vonë se gjetiu, si pasojë e historisë tragjike të vendit në dekadat e fundit, shkaktuar nga politikat violente dhe represive të diktatorit serb **S. Millosheviq**. Në Kosovë, njëjtë si në vendet tjera ish-komuniste, kushtetuta dhe ligjet qe bazohen në të, burojnë nga vullneti i shoqërisë në tranzicion dhe janë një instrument i ndryshimit të vetë kësaj shoqërie në tranzicion.[29] Ndryshimi i dëshiruar në rastin e Kosovës mëton ndërtimin e një identiteti të ri të Kosovës, identitetit kosovar, i cili nuk reflekton nivelin socio-kulturore të shoqërisë së saj. Shikuar nga kjo perspektiv, ky identitet i ri kosovar që synohet të arrihet, përfaqëson një ndarje radikale me të kaluarën e Kosovës.

---

[28] Themelimi i Gjykatës është bërë me **Ligjin nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës** të datës 16 dhjetor 2008, në fuqi nga data 15 janar 2009 kur është shpallur në **Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës** Nr.46/2009. Sipas nenit 58 ["Hyrja në Fuqi"] të Ligjit, hyrja e tij në fuqi është bërë ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare.
Përbërja e parë e **GJKRKS** është zgjedhur më 26 qershor 2009 dhe ka pasur këtë formacion:

- Enver Hasani, kryetar
- Altay Surroi, gjyqtar
- Ivan Cukalloviq, gjyqtar
- Kadri Kryeziu, gjyqtar
- Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare
- Iliriana Islami, gjyqtare
- Robert Carolan, gjyqtar
- Almiro Rodriguez, gjyqtare
- Snezhana Biotusharova, gjyqtare

Sipas Kushtetutës së vitit 2008, përkatësisht dispozitave të saj mbi pavarësinë e mbikëqyrur që kanë vlejtur deri në shtator të vitit 2012, në përbërjen e saj kanë qenë tre gjyqtarë ndërkombëtarë. Këta kanë vazhduar edhe për gjashtë vjet tjera mandatin e tyre, sipas një këmbi të letrave që është bërë në mes të Kosovës dhe **Bashkimit Evropian**. Për këtë do të diskutohet në kapitullin në vijim kur të flasim për themelimin dhe punën e GJKRKS, juridiksionin, vendin dhe rolin e saj në sistemin kushtetuese dhe politik të Kosovës së pavarur dhe sovrane.
Vendimi i saj i parë ka qenë në rastin **KI 11/09: Tomë Krasniqi vs RTK dhe KEK**, datë 16 tetor 2009, dhe ka pasur të bëjë me vënien e masës së përkohshme që ndalonte zbatimin e Ligjit për RTK-në deri në vendosjen meritore të rastit.
Seanca e parë dëgjimore për këtë rast është mbajtur më 6 tetor 2009 në gjykatoren e **Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës**. Kjo sepse në këtë kohë ende nuk ka qenë ndërtuar gjykatorja e **GJKRKS.** Për këtë dhe gjërat që lidhen me nisjen e punës së saj flasim në kapitujt në vijim.

[29] Ruti Teitel "Transitional Rule of Law". Në Adam Czamota, Martin Krygeier and Wojciech Sadurski (eds.), *Rethinking the Rule of Law After Communism* (CEU Press: Budapest, 2005) fq. 279.

Ndarja e tillë është reflektuar në parimet, vlerat, normat dhe zakonet kushtetuese të Kushtetutës së vitit 2008, të cilat nuk janë në harmoni më parimet, vlerat, normat dhe zakonet e nivelit lokal kosovar.[30] Kushtetuta, me fjalë të tjera, reflekton parimet, normat, vlerat dhe zakonet e konstitucionalizmit liberal perëndimor. Një rrethanë e tillë më së shumti shihet nga pjesët e saj që normojnë të drejtat e njeriut, përkatësisht kapitujt II ["Të Drejtat dhe Liritë Themelore"] dhe III ["Të Drejtat e Komuniteteve dhe Anëtarëve të Tyre], si dhe ato pjesë që normojnë juridiksionin, vendin dhe rolin e Gjykatës Kushtetuese.[31]

GJKRKS, siç do të shihet më vonë në seksionin e fundit të këtij kapitulli dhe në kapitujt në vijim të librit, ka shërbyer që nga themelimi i saj në fillim të vitit 2009, si një mekanizëm kyç për vënien në jetë të të drejtave dhe lirive fundamentale të mishëruara në kapitullin II dhe III të Kushtetutës. Interpretimi i këtyre dy kapitujve nga ana e saj, ka qenë krejtësisht i ri, siç ka qenë rasti me sistemet kushtetuese të vendeve ish-komuniste që kanë **institutin e ankesës kushtetuese**, dhe ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe esenciale në formësimin e identitetit të ri kushtetues të Kosovës. Kjo është kështu sepse interpretimi i saj kushtetues nuk mund të ndodhë duke u bazuar në strukturën materiale ekzistuese të shoqërisë kosovare, por në unitetin strukturor ndërmjet germës dhe frymës së Kushtetutës dhe parimeve, vlerave, normave dhe zakoneve të shoqërive liberale perëndimore. Me kalimin e kohës, ky raport mund të ndryshojë, ashtu që edhe vlerat dhe parimet e konstitucionalizmit perëndimor bëhen pjesë integrale e identitetit të ri kosovar ashtu siç përcaktohet sot me tekstin e Kushtetutës së vitit 2008.

Seksioni në vijim ndahet në disa pjesë që fokusohen në zhvillimin kushtetues të Kosovës për aq sa mund të flitet për një gjë të tillë, marrë parasysh faktin se **Kosova** për një kohë të gjatë nuk ka pasur identitet të ndarë kushtetues. Në këtë kuptim, narrativi ynë fillon me paraqitjen e ngjarjeve që kanë të bëjnë me kohën para ardhjes së diktatorit serb **S. Milosheviq** në pushtet në vitin 1986. Kjo kohë përfshin zhvillimin kushtetues të **Kosovës** para dhe pas miratimit të Kushtetutës së vitit 1974. Kjo pjesë pasohet me narrativin që flet për kohën millosheviqiane deri në hyrjen e trupave të **NATO**-s dhe **Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës** (UÇK) në **Kosovë** më 10 qershor 1999. Me këtë datë Kosova është vënë nën administrim ndërkombëtar bazuar në Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (KS) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Ky narrativ kap periudhën dhe ngjarjet deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 dhe sqaron formën dhe përmbajtjen e dizajnit aktual kushtetues të Kosovës dhe të vetë gjyqësisë kushtetuese. Këtu mbaron tregimi i këtij kapitulli, për t'i lëshuar udhë kapitullit në vijim, kapitullit të njëmbëdhjetë, në të cilin më konkretisht flasim lidhur me **GJKRKS,** lindjen, juridiksionin si dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me jetën dhe punën e saj.

Ky kapitull, në krahasim me atë që pason, flet kryesisht për zhvillimin kushtetues të **Kosovës**. Kjo nga fakti se gjyqësia kushtetuese kosovare në këtë periudhë thuajse nuk ka ekzistuar deri në vitin 1972. Për këtë arsye ka shumë rëndësi që lexuesi të mësojë më shumë për zhvillimin kushtetues të Kosovës përgjatë kohës sa ka ekzistuar ish-Jugosllavia (1918-1992), si dhe gjatë kohës së integrimit të dhunshëm të Kosovës në sistemin serb pas datës 23 mars 1989.

---

[30] Për një mendim i cili thot se identiteti kushtetues ndjek traditat nacionale dhe strukturën materiale të shoqërisë së dhënë, shih më shumë në Georg P. Fletcher, "Constitutional Identity". In Michel Rosenfeld (ed.), *Constitutionalism, Identity, Difference, and Legitimacy* (Duke University Press: Durham and London, 1994) fq. 223-232; Për një mendim krejt të kundërt, i cili thotë se kushtetuta, ligjet dhe gjykatat janë ato që qëndrojnë prapa konstitucionalizmit modern, jo rregulli mbi sundimin e shumicës, shih më shumë në: Ruti G. Teitel, "Reactionary Constitutional Identity". Në Michel Rosenfeld (ed.), *Constitutionalism, Identity, Difference, and Legitimacy,* fq. 233-243; Catherine Dupre and Jiunn -rong Yeh, "Constitutions and legitimacy over time". Në Mark Tushnet, Thomas Fleiner and Cheryl Saunders (eds.), *Rutledge Handbook of Constitutional Law* (Rutledge and London, 2013) fq. 45-54.

[31] Më fjalë të tjera, kushtetuta dhe interpretimi i saj janë përcaktuesit e identitetit të një shoqërie, jo struktura materiale e shoqërisë. Kjo qasje fillon me **Aristotelin**. Cf. Ernest Baker (Ed. and Transl.), *The Politics of Aristotle* (Oxford University Press: Oxford, 1962) fq.98-99; Michel Rosenfeld, "Modern Constitutionalism as Interplay Betëeen Identity and Diversity." Në Michel Rosenfeld (ed.), *Constitutionalism, Identity, Difference, and Legitimacy,* fq. 3-35; Garry Jeffrey Jacobson, *Constitutional Identity* (The President and Felloës of the Harvard College: Harvard, 2010) fq. 8-10; Michel Rosenfeld, "Constitutional Identity." Në Michel Rosenfeld and Andras Sajo (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law* (Oxford University Press: Oxford, 2012) fq. 756-776.

10.1. Periudha deri në nxjerrjen e Kushtetutës së vitit 1974

Gjatë Mbretërisë **SKS/Jugosllavisë** (1918-1943), Kosova nuk ka pasur identitet të veçantë kushtetues e as identitet tjetër politik apo territorial. Ajo nuk ka qenë e njohur si territor i veçantë, kurse popullsia e saj nuk ka gëzuar asnjë njohje kushtetuese Në këtë drejtim, Kosova nuk ka qenë e vetme: boshnjakët, malazezet dhe maqedonasit gjithashtu nuk kanë gëzuar asnjë njohje kushtetuese (në aspektin nacional apo territorial). Kjo gjendje ka qenë pasojë e mënyrës së formimit të ish-Jugosllavisë më 1 dhjetor 1918, si dhe e rrethanave historike që i kanë paraprirë këtij formimi. Këto dy aspekte më pas janë reflektuar në të gjitha dokumentet kushtetuese jugosllave deri në shkatërrimin e parë të atij shteti më 6 prill 1941 nga sulmi ushtarak i **Gjermanisë së Hitlerit.**

Në krijimin e këtij shteti pas mbarimit të **Luftës së Parë Botërore** kanë ndikuar disa faktorë. Në rend të parë ka qenë urrejtja ndaj austro-hungarezëve dhe otomaneve, e kultivuar me zell të madh nga ana e sllavëve të jugut përgjatë thuajse tërë shekullit XIX. Faktor tjetër shumë i rëndësishëm ka qenë ideja i jugosllavizmit, që u kultivua përgjatë shekullit XIX si në veri të shtetit të ardhshëm jugosllav ashtu edhe në jug të tij. Esenca e idesë jugosllave në veri kishte kuptimin e promovimit të një autonomie kulturore e politike të sllovenëve dhe kroatëve, një lloj federate me vëllezërit serbë në pjesën jugore të asaj që më vonë do të njihet si **Jugosllavi** (malazezët, maqedonasit dhe boshnjakët as që konsideroheshin si popuj të veçantë). Këta të fundit, pra jugorët serbë të atij shteti, idenë e jugosllavizmit e shihnin si një shans për hegjemoni politike dhe sundim të tërësishëm të kulturave e popujve jo serbë, përkatësisht realizim të idesë së tyre për **Serbinë e Madhe**. E thënë me fjalë të tjera, për serbët jugosllavizmi nënkuptonte realizimin efektiv të projektit të **Serbisë së Madhe**, kurse për sllovenët dhe kroatët kjo ide shihej si diçka që realizonte aspiratat e tyre liberale për një federatë të sllavëve të jugut.

Këto dy pikëpamje, diametralisht të kundërta, u përafruan për herë të parë në **Marrëveshjen e Korfuzit** (1917): me ndërmjetësimin e **Francës** dhe **Britanisë së Madhe,** përfaqësuesit serb, sllloven dhe kroat të Austro-Hungarisë dhe **Qeveria e Mbretërisë së Serbisë** në mërgim, i a.q **Komiteti Jugosllav**, nënshkruan një deklaratë të përbashkët për themelimin e Jugosllavisë si një demokraci kushtetuese me rregullim mbretëror nën dinastinë serbe **Karagjorgjeviq.**[32] Lideri nacionalist serb dhe kryeministri i kohës, **Nikolla Pashiq** (Nikola Pasiç: 1845-1925), që avokonte idenë për zgjerim të njëanshëm të **Serbisë**, u detyrua të pajtohet me kushtet e **Marrëveshjes së Korfuzit**. Kjo për shkak se, pas revolucionit të tetorit 1917, **Rusia** më nuk kishte asnjë mundësi për të ndikuar në rrjedhat botërore dhe për të mbrojtur nacionalizmin serb. Tani e tutje Bashkimi Sovjetik u pa si një rrezik i madh për paqen, sigurinë dhe stabilitetin evropian. Për pasojë, krijimi i shteteve të reja në Evropë në hapësirën në mes të shtetit të ri sovjetik dhe pjesës perëndimore dhe qendrore të Evropës u pa si një mjet për ndërtimin e një cordone sanitaire pengues dhe si një barrierë e përhapjes së komunizmit bolshevik. Tri kanë qenë shtetet e reja që u krijuan pas Luftës së Parë Botërore në vijim të realizimit të kësaj arkitekture të re të sigurisë dhe stabilitetit evropian – **Polonia, Çekosllovakia** dhe **Jugosllavia**.

Jugosllavia u themelua në Versajë, njëjtë si Polonia dhe Çekosllovakia. Në fillim u duk sikur u prish dualizmi në botëkuptimet rreth **Jugosllavisë** që kishin qenë prezente gjatë dhe para **Luftës së Parë Botërore**. Kjo, megjithatë, nuk doli të jetë kështu: **Mbretëria SKS** në praktikë u shndërrua në një **Serbi të Madhe,** sepse pushteti në tërësi ngeli i centralizuar dhe në duar të serbëve. Ëndrra e **Komitetit Jugosllav** për një federatë të tre popujve dhe për një autonomi të gjerë kulturore e politike të tyre nuk u realizua. Kjo ndodhi si rezultat i fitoreve ushtarake serbe në **Luftën e Parë Botërore** (1914-1918) dhe në **Luftërat Ballkanike** (1912-1913), të cilat bënë që raporti i forcave në terren të jetë në anën e serbëve. Ky raport ushtarak i forcave ka qenë vendimtar për përcaktimin e natyrës së mbretërisë së re që po krijohej, natyrë që ngeli deri në fund despotike dhe e dominuar nga serbët.

[32] Për **Deklaratën e Korfuzit** dhe rëndësinë e saj në themelimin e ish **Jugosllavisë**, Cf. Vladislav B. Sotiroviq: "The 1917 Corfus Declaration and its Importance for the Creation of the Kingdom of Serbs, Croats and Slovenes in 1918" *The South Slav Journal*, Vol. 33 No. 1−2 (London−Belgrade: Spring, 2014) fq. 7−35.

Akti themelues i datës 1 dhjetor 1918 paraqet dokumentin e parë me rëndësi kushtetuese në procesin e krijimit të ish-Jugosllavisë. Me këtë akt, mbreti serb i dinastisë **Karagjorgjeviq** proklamoi bashkimin e **Mbretërisë së Serbisë** me vendet e banuara me sllovenë, kroatë dhe serbë që i kishin takuar **Austro-Hungarisë**. Si i tillë, ai shërbeu si bazë juridike për themelimin e pushtetit të ri dhe ngeli në jetë derisa u nxor **Kushtetutës së Vidovdanit** më 28 qershor 1921. Në këtë periudhë, pushtetin e kanë përfaqësuar mbreti, përkatësisht regjenti **Aleksandër Karagjorgjeviq**, qeveria dhe **Kuvendi i Përkohshëm Përfaqësues Popullor** (**Kuvendi Përkohshëm**). Më datën 20 dhjetor 1918, u bë formimi i qeverisë së parë, kurse Kuvendi Përkohshëm u takua më datën 1 mars të vitit në vijim. Sikundër shihet, me këtë akt, as që ka mundur të imagjinohet ekzistimi i ndonjë kontrolli kushtetues i aktivitetit të autoriteteve shtetërore si pasojë e pushtetit absolut dhe të centralizuar të mbretit serb. Kjo rrethanë vinte si pasojë e raportit të forcave në favor të serbëve, të cilët kishin detyruar popujt tjerë jo serbë për unifikim me **Mbretërinë Serbe** para se të themelohej shteti i ri jugosllav: në nëntor të vitit 1918 u aneksua **Mbretëria e Malit të Zi** (1910-1918), së bashku me **Vojvodinën** dhe vendet tjera që gjendeshin nën okupim ushtarak serb. Për këtë kemi diskutuar më herët në kapitullin e pestë.

Si detyrë e parë e shtetit të ri, që dilte nga premtimi i dhënë me aktin e datës 1 dhjetor 1918, nga regjenti **Aleksandar Karagjorgjeviq** në emër të mbretit serb **Petri i Parë**, ka qenë themelimi i qeverisë, e cila do t'i përgjigjej kuvendit, si dhe caktimi i kufijve mbi bazën e parimit etnografik. Kjo e fundi nuk ka ndodhur asnjëherë gjatë tërë kohës së ekzistimit të atij shteti. Kjo nuk ka ndodhur sepse asnjëherë seriozisht nuk është menduar caktimi i kufijve mbi baza të tilla, me përjashtim të **Banovinës Kroate**, e cila u krijua në vitet e fundit të jetës së atij shteti.[33] Kjo gjendje e sundimit autoritar të dinastisë Karagjorgjeviq u reflektua edhe në kushtetutën e parë, e njohur si **Kushtetuta e Vidovdanit** (festë kishtare serbe).

Kushtetuta e Vidovdanit u miratua nga një kuvend kushtetues më datën 28 qershor 1921. Miratimi u bë me një shumicë të thjeshtë të votave dhe me një refuzim të tërësishëm të saj nga sllovenët dhe kroatët. Refuzimi synonte të bllokonte tendencat hegjemoniste serbe dhe ishte pasojë e drejtpërdrejtë e dallimeve thelbësore në mes të serbëve, në njërën anë, dhe sllovenëve e kroatëve, në anën tjetër, sa i përket rregullimit shtetëror dhe formës së qeverisjes: derisa sllovenët e kroatët insistonin për një rregullim shtetëror republikan me bazë federative, serbët fuqishëm dhe me dhunë insistonin për një rregullimin monarkik unitar dhe me pushtet të centralizuar. Në aspektin formal, Kushtetuta bënte fjalë për barazi në mes të tre popujve në ndarjen e pushtetit të ri. Në praktikë, megjithatë, mbreti merrte pjesë në ushtrimin e tri formave të pushtetit. Rregullimi kushtetues centralist, ndërkaq, buronte nga botëkuptimi serb i kohës mbi unitetin shtetëror i cili shprehej përmes formulës së njohur që thoshte se **Mbretëria SKS** paraqet një mbretëri të një populli me tre emra. Këta tre emra ishin: kroatët, serbët dhe sllovenët.[34]

U mor vesh, kjo nuk ka reflektuar realitetin gjë që shihet nga fakti se serbët tërë kohën e ekzistimit të këtij shteti kanë pasur problem jo vetëm me kroatët dhe sllovenët, por edhe me të gjithë popujt tjerë. Kushtetuta dhe serbët nuk pranonin se ekzistonin popujt të tjerë, të cilët ata i shihnin në kuadër të identitetit shtetëror unitar serb. Kjo u pa më së miri kur u nxor **Dekreti mbi ndarjen vendit në rrethe** më datën 26 prill 1922. Sipas këtij dekreti, **Mbretëria SKS** u nda në 33 rrethe, kryesisht sipas kritereve gjeografike, sociale, ekonomike dhe aspak në bazë të kritereve etnike apo historike.[35]

---

33 Cf. fusnotën nr. 2, **supra**, si dhe teksti që e shoqëron.

34 Për një trajtim të shkëlqyer të pikëpamjeve serbe, në njerën anë, dhe të atyre kroato-sllovene, në anën tjetër, të cilat u sanksionuan me Kushtetutën e Vidovdanit në favor të serbëve dhe botëkuptimit të tyre mbi unitetin shtetëror, si kundërpozicion ndaj konceptit federalist të kroatëve e sllovenëve, shih më shumë në librin e konstituciuonalistit të mirënjohur serb Slobodan Jovanovic, *Ustavno pravo Kraljevine srba, hrvata i slovenaca* (Sluzbeni list SRJ: Beograd, 1995) (në alfabetin cirilik vetëm) fq. 31-98 (në kapitullin hyrës autori jep historinë e procesit të formimit të **Jugosllavisë** gjatë dhe pas **Luftës së Parë Botërore**, dallimet në mes të projekteve kushtetuese kroate e sllovene me ato centraliste serbe; në dy kapitujt e parë të pjesës së parë, autori flet në mënyrë të detajuar rreth konceptit të mbretërisë që thuhej se qe e përbërë nga një popull me tre emra, kundërshtimet sllovene dhe kroate të këtij koncepti, arsyet për një kundërshtim të tillë dhe kështu me radhë)

35 Cf. fusnotën nr. 2, **supra**, si dhe teksti që e shoqëron.

Në fakt, në **Kuvendin Kushtetues** që miratoi **Kushtetutën e Vidvdanit**, partitë serbe dhe aleatët e tyre në mënyrë shumë të hapur insistuan dhe realizuan konceptin që rrënonte çdo ndarje të mëparshme administrative që bazohej në kritere historike dhe kombëtare. Ky rrënim i identiteteve të vjetra historike dhe etnike bëhej me arsyetimin se, si të tilla, ato paraqisnin zgjidhje të imponuara nga sundimtarët e huaj. Më sundimtar të huaj nënkuptoheshin, në rend të parë, austro-hungarezët meqë ankesat dhe kundërshtimet vinin nga kroatët dhe sllovenët, si ish-shtetas austro-hungarezë.[36] Sa i përket sundimtarëve otomanë, territoret dhe popujt e sunduar nga ta nuk paraqisnin ndonjë problem sepse nuk kishin asnjë ndikim në rregullimin e ri kushtetues.

Kjo qasje përbënte një politikë zyrtare që shtypte çdo diveristet nacional, gjuhësor dhe tjetër në favor të theksimit të tezës se **Mbretëria SKS** ishte një dhe e vetme, e një populli me tre emra. Si e tillë nuk ndryshoi aspak me abrogimin e **Kushtetutës së Vidovdanit** dhe futjen e diktaturës së njohur më 6 janar 1929. Pushteti unik, i pandarë dhe tërësisht i centralizuar i dinastisë serbe **Karagjorgjeviq**, si dhe ideologjia e **jugosllavizmit** integral nuk pranonin asnjë diversitet nacional, etnik, gjuhësor dhe tjetër. Me rastin e futjes së kësaj diktature, në mënyrë shumë brutale dhe të hapur, mbreti serb **A. Karagjorgjviq** shpërndau parlamentin dhe imponoi regjimin personal.[37]

Qeveria, nën urdhrat direkte të mbretit nxori disa ligje me të cilat abrogoi dispozitat e **Kushtetutës së Vidovdanit** që kishin të bënin me pushtetin mbretëror dhe administratën shtetërore, jetën publike dhe politike, lirinë e shtypit dhe, së fundi, me organizimin territorial dhe vetëqeverisjen lokale. Vetëqeverisja lokale dhe administrata shtetërore nuk bazoheshin aspak në kritere të barazisë nacionale, etnike, fetare, gjuhësore apo tjetër: sërish erdhi në shprehje mohimi i tërësishëm i çfarëdo diversiteti etnik, nacional apo gjuhësor si bazë për caktimin e njësive të vetëqeverisjes lokale dhe të administratës shtetërore territoriale. Vetëm tri administrata komunale u përcaktuan me dekret mbretëror, kurse mëkëmbësit e mbretit, të njohur si **zhupanët e mëdhenj**, u autorizuan si të plotfuqishëm për të udhëhequr me administratat tjera komunale. Tri administratat komunale që u caktuan me dekret mbretëror kanë qenë: **Beogradi**, **Zagrebi** dhe **Lubjana**.

As këtu në këtë kohë nuk mund të bëhet fjalë për ekzistimin e ndonjë shenje të gjyqësisë kushtetuese, sado e vogël qoftë ajo indicie. Kjo për arsye se këtu ka qenë fjala për një diktaturë të hapur personale të mbretit serb dhe koncentrim të tërësishëm të pushtetit në duart e tij. Diktatura personale, sipas definicionit, është në kundërshtim me konceptin e gjyqësisë kushtetuese si një aktivitet publik që ka për qëllim primar sigurinë e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës dhe të rendit objektiv të bazuar në te, rend ku krahas organizimit të pushtetit publik mbi parimin e ndarjes dhe balancimit, garantimi dhe mbrojtja e lirive e të drejtave kushtetuese zë një vend të veçantë.

Me rastin e futjes së diktaturës personale, mbreti serb pat paralajmëruar rikthimin në gjendjen kushtetuese në një afat sa më të shkurtër. Kjo ka ndodhur falë situatës ndërkombëtare që nuk shkonte në dobi të hegjemonizmit serb të kohës që cenonte stabilitetin dhe sigurinë evropiane të krijuar në **Versajë**.[38] Kësisoj,

---

[36] Për debatet dhe pikëpamjet e kundërta ndërmjet serbëve, kroatëve dhe sllovenëve, si dhe për arsyetimet përfundimtare për miratimin e konceptit serb mbi unitetin shtetëror dhe rrënimin e çdo identiteti historik, kulturor dhe etnik gjatë caktimit të njësive të reja të vetëqeverisjes lokale, cf. më shumë në Slobodan Jovanovic, *Ustavno pravo Kraljevine srba, hrvata i slovenaca*, fq. 94-98.

[37] Me ideologjinë e **jugosllavizmit integral** dhe një administratë shtetërore tërësisht të centralizuar, diktatura e 6 janarit të vitit 1929 ka prodhuar separatizëm të fuqishëm në mesin e popujve joserb. Cf. Latinka Përović, *Kraljevina Srba, Hrvata i Slovenaca (1918–1929)/Kraljevina Jugoslavija (1929–1941): nastanak, trajanje i kraj* (Beograd, 2015) fq. 14.

[38] **Franca** kishte qenë sponsori kryesor i krijimit të **Jugosllavisë** më 1 dhjetor 1918. Në literaturë quhet, jo pa të drejtë, **Jugosllavia e Versajës**. Kjo sepse roli i **Francës** kishte qenë kryesor në themelimin e këtij shteti, sikundër edhe në themelimin e **Cekosllovakisë** dhe **Polonisë**. Një politikë e tillë franceze, e përkrahur edhe nga **Britania e Madhe**, **SHBA**-të dhe vendet e tjera perëndimore ka qenë pasojë e fitimit të komunizmit në **Rusi** dhe krijimit të ish-**BRSS** dhe rrezikut që ajo krijesë paraqiste ndaj civilizimit perëndimor judeo – kristian, ashtu siç e njohim sot. Në këtë kontekst, **Jugosllavia e Versajës** ka shërbyer si një **cordone sanitaire**, pikërisht për të veçuar rolin e saj në pengimin e përhapjes poshtë në **Evropë** të forcës së pakontrolluar dhe anarkike të shtetit të ri të sovjetëve dhe ideologjisë komuniste të komisarëve rus, shtet që ishte krijuar në vitet e fundit të **Luftës së Parë Botërore**, përkatësisht më 25 tetor 1917. Cf. Antony Best, Jussi Hanhimaki, Joseph A. Maiolo, Kirsten E. Schulze, *International History of the Twentieth Century and Beyond* (Routledge: New York, 2015) fq. 48.

më datën 3 shtator 1931, mbreti i dha fund diktaturës personale dhe riktheu në vend rendin kushtetues, por vetëm në aspektin formal. Në aspektin substancial, asgjë nuk kishte ndryshuar nga koncepti fillestar: Shteti bazohej në hegjemoninë serbe ku ende vlente teza mbi ekzistimin e një kombi unik me tre emra, i cili, nga viti 1929, cilësohej si "kombi jugosllav". Ky popull ekzistonte, megjithatë, vetëm në interpretimin serb, të cilët nuk fshihnin qëllimin e tyre për dominim të tërësishëm të popujve dhe kulturave jo serbe. Ajo që fillimisht u quajt një popull me tre emra, tani formalisht u cilësua si **kombi jugosllav**. Një hap i tillë ishte në plotni në pajtim me botëkuptimet serbe për hegjemoni ndaj tjerëve.[39] Këtë interpretim serbët e kanë edhe sot dhe asnjëherë nuk e kanë ndryshuar, gjë që shihet nga tekstet e të gjitha kushtetutave serbe të miratuara pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë në vitin 1992.

Administrata shtetërore në **Mbretërinë SKS** organizohej nëpër banovina, qarqe dhe komuna. Me Kushtetutë u caktuan nëntë banovina të reja së bashku me kufijtë e tyre të rinj, të cilat më herët ishin caktuar me **Ligjin e 3 tetorit 1929 mbi emërtimin dhe ndarjen e Mbretërisë.**[40] Me këtë ligj, në fakt, është ndryshuar emri nga **Mbretëria SKS** në **Mbretëria e Jugosllave**, të cilin e ka ruajtur deri në shkatërrimin e saj në Luftën e Dytë Botërore.

Kushtetuta e Jugosllavisë e 3 shtatorit të vitit 1931, për herë të parë në Evropë përcaktonte kufijtë administrativë të territoreve të caktuara, të njohura si **banovina.**[41] Kjo nënkuptonte se, tani e tutje, kufijtë administrativë të banovinave mund të ndryshonin vetëm me Kushtetutë. Kjo paraqet një risi dhe një progres në kuptim të zhvillimit të së drejtës kushtetuese të këtij vendi. Dy nene kanë ekzistuar, megjithatë, që kanë zhvlerësuar rëndësinë e këtij garancioni kushtetues: neni 116 ["Ndryshimet në Kushtetutë] dhe neni 118 ["Dispozitat Kalimtare] i Kushtetutës. Ky i fundit përcaktonte se në fuqi do të mbeteshin të gjitha ligjet e nxjerra para hyrjes në fuqi të Kushtetutës (së 3 shtatorit 1931), përveç Ligjit mbi pushtetin mbretëror dhe administratën supreme shtetërore, datë 6 janar 1929 (më të cilin ligj, në fakt, ishte futur diktatura mbretërore e 6 janarit, e përshkruar si më sipër).

Neni 116 i Kushtetutës, ndërkaq, i cilësuar si **kushtetuta e vogël**, i jepte të drejtë Mbretit jugosllav që në gjendje të jashtëzakonshme të ndërmerrte masa të caktuara kundërkushtetuese dhe kundërligjore, me kusht që ato të ratifikoheshin më vonë nga ana e organit përfaqësues jugosllav.[42] Në bazë të këtij neni, në prag të **Luftës së Dytë Botërore** është miratuar **Dekreti mbi Banovinën e Kroacisë**, i nxjerrë nga princi **Pavle Karagjorgjeviq** në emër të **Petrit të Dytë Karagjorgjeviq** (atëherë i mitur).[43] Me këtë dekret, **Banovina e Kroacisë** kishte territorin e ndarë, kompetenca dhe organizim të veçantë. Kjo përbënte të vetmin përjashtim nga parimi i unitetit të pushtetit mbretëror dhe inte-

---

39 Për idetë serbe për këtë popull me tre emra, si dhe për kundërshtimin e tyre të idesë së kombit jugosllav, që fillimisht reflektonte barazinë e të gjithëve, cf. më shumë në Slobodan Jovanoviq, *Ustavno pravo Kraljevine srba, hrvata i slovenaca*, fq. 45-72 & 89-91; Kombi jugosllav u krijua në vitin 1931 si vënie në jetë të idesë serbe mbi integralizmin jugosllav dhe hegjemoninë serbe, jo për të reflektuar barazinë në mes të popujve që përbënin atë shtet.

40 Cituar sipas Latinka Perović, *Kraljevina Srba, Hrvata i Slovenaca (1918–1929) / Kraljevina Jugoslavija (1929–1941)*, fq. 12-13.

41 Cf. Neni 83 ["Pushteti Administrativ"] i Kushtetutës. Në paragrafin e fundit të këtij neni thuhet se kufijt e **banovinave** në detaje në rast të kontestit i cakon Ministri i Punëve të Brendshme. Neni në vijim, neni 84, e bënë të qartë se themelimi I banovinave nuk bazohet në kriterin etnik, nacional, kulturor apo tjetër që do të reflektonte diversitetin multietnik, multinacional dhe multikultural të Mbretërisë. Në këtë nen qartë thuhet se **banovinat** janë njëesi të administrimit dhe vetëqveverisjes lokale.
Banovinat e kësaj kohe, me fjalë tjera, nuk kishin fare karakter etnik, nacional, gjuhësor apo kulturor. Vetëm me themelimin e **Banovinës Kroate** u bë, për herë të parë, themelimi i një territori administrativ brenda **Mbretësisë së Jugosllavisë** që reflektonte në shumicën e vet diversitetin nacional të këtij territori (i banuar me shumicë kroate në një hapsirë që historikisht kishte qenë kroate).

42 Устав Краљевине Југославије (1931). Në internet: https://sr.wikisource.org/wiki/Устав_Краљевине_Југос лав иje_ (1931) (shikuar në dhjetor 2017).

43 *Uredba o Banovini Hrvatskoj* (datë 26 gusht 1939)**.** Për tekstin e plotë të Dekretit, shih në këtë veb faqe: https://hr.wikisource.org/ wiki/Uredba_o_banovini Hrvatskoj (shikuar në dhjetor 2017).
Banovina Kroate gjatë tërë kohës u cilësua si një realizim i një projekti gjyqësm federal dhe i ëndërrës kroate për liri dhe pavarësi nga hegjemnozimi serb. Cf. Srdja Pavlovic, *Balkan Anschluss: The Annexation of Montenegro and the Creation of the Common South Slavic State* (Purdue University Press: West Lafayette, Indiana, 2008) fq. 49-50; **Alex N. Dragnich**, *The First Yugoslavia: Search for a Viable Political System* (Hoover Institution Press: Stanford, California, 1983) **fq.** 129.

gralizmit jugosllav, që ishin proklamuar si një politikë zyrtare e këtij shteti.[44] Në aspektin kushtetues, për kohën e vet përbënte një lloj zbulimi, nisur nga fakti se fjala ka qenë për një monarki me pushtet personal absolut të dinastisë serbe Karagjorgjeviq, e mbështetur në ideologjinë e integralizmit jugosllav, e cila tani po i bënte lëshime vetëm një kombi, që cilësohej si themelues i Shtetit, kombit kroat, duke ia njohur atij një autonomi të gjerë politiko-organizative. Kjo, megjithatë, nuk ndryshoi natyrën e Shtetit jugosllav: ai ngeli deri në fund një monarki, ku pushteti i takonte, në formë të drejtpërdrejt apo të tërthorët, vetëm mbretit serb të dinastisë **Karagjorgjeviq.**

Në aspektin e gjyqësisë kushtetuese, sigurisht që as këtu nuk mund të flitet për asgjë konkrete: gjërat, konceptualisht, nuk kishin ndryshuar aspak nga koha e kaluar. Pushteti i kurorës serbe ngelej i paprekur dhe nuk i nënshtrohej asnjë kontrolli nga jashtë, kurse neni 116 i Kushtetutës përbënte një kërcënim në hije për të gjithë ata që mëtonin kufizimin e kontrollit absolut të mbretit. Si pjesë e këtij koncepti, që binte ndesh me natyrën dhe funksionin parësor të gjyqësisë kushtetuese, ishte fakti se vetë Kushtetuta e vitit 1931 ka qenë një kushtetutë e dhuruar. Do të ishte absurde pritja që rendi kushtetues i bazuar në një kushtetutë të tillë t'i nënshtrohet një kontrolli kushtetues nga jashtë, me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së tij kundrejt rendeve të tjera juridike. Supremacia (epërsia) e Kushtetutës së vitit 1931 dhe sigurimi i rendit objektiv kushtetues të Shtetit bëhej nga vetë dhuruesi, mbreti serb i dinastisë **Karagjorgjeviq,** kurse të drejtat dhe liritë njerëzore supozohej se janë në funksion të sigurimit të kësaj supremacie (epërsie) mbretërore të dinastisë **Karagjorgjeviq**.

Koncesionet e bëra ndaj kroatëve ishin politikë ditore e kohës, jo si veprime që synonin kufizimin apo zbutjen e pushtetit mbretëror: lëshimet ndaj kroatëve tregonin se Shteti jugosllav është dashur të ndërtohej që nga fillimi sipas kritereve të tjera, ku të reflektoheshin dallimet e thella etnike, nacionale, gjuhësore, kulturore dhe të tjera. Kjo u bë e qartë me fillimin e **Luftës së Dytë Botërore**, kur u shpërfaq në tërësi ashpërsia e konfliktit në mes të popujve që e përbënin atë shtet. I ashpër dhe brutal ka qenë jo vetëm konflikti i serbeve me kroatët dhe sllovenët, të cilit më 1 dhjetor 1918 kishin pritur që shteti i ri do të akomodonte interesat dhe aspiratat e tyre nacionale, por edhe konflikti me malazezët, maqedonasit, boshnjakët dhe shqiptarët. Këta popuj as që figuronin si kombe apo etni të veçanta të atij shteti. Ata cilësohen thjeshtë si **jugosllavë**, pa asnjë identitet tjetër të veçantë në pikëpamje etnike, nacionale, gjuhësore, kulturore dhe tjetër.

Nga okupimi i ish-**Jugosllavisë** në prill të vitit 1941, nën rrënojat e saj u krijuan disa shtete të pavarura, nën diktatin gjerman e italian, të cilat manifestonin një anti-jugosllavizëm të tërbuar si pasojë e politikave represive të **Jugosllavisë** mbretërore të dominuar nga serbët. Këto entitete shtetërore nuk u njohën nga e drejta ndërkombëtare e kohës: kjo u bë e qartë me **Kartën e Atlantikut** të datës 14 gusht 1941, dhe u konfirmua më pastaj me të gjitha dokumentet tjera të karakterit të detyrueshëm ndërkombëtar të nxjerra gjatë **Luftës së Dytë Botërore.**[45] Kjo nënkuptonte se, në aspektin juridik - ndërkombëtar, **Jugosllavia** kishte ruajtur integritetin e vet territorial, njëjtë siç

---

[44] Në literaturë është vërejtur se themelimi i Banovinës Kroate ka qenë një hap në drejtim të ndarjes së Mbretërisë së Jugosllavisë në mes të kroatve, serbëve dhe sllovenëve, duke përjashtuar popujt dhe etnitë tjera. Si pasojë e Luftës së Dytë Botërore, për popujt tjerë, pra për serbët dhe sllovenët, nuk u arritur themelimi i banovinave serbe e sllovene respektivisht. Banovina Kroate gjatë tërë kohës u cilësua si një realizim i një projekti gjyqësm federal dhe i ëndrrës kroate për liri dhe pavarësi nga hegjemnozimi serb. Cf. Srdja Pavlovic, *Balkan Anschluss:The Annexation of Montenegro and the Creation of the Common South Slavic State*, fq. 49-50; **Alex N. Dragnich**, *The First Yugoslavia: Search for a Viable Political* System, **fq.** 129.
Për popujt tjerë as që bëhej fjalë sipas botëkuptimit të kohës që lidhej me natyrën e këtij shteti: integralizmi jugosllav efektivisht nënkuptionte që kjo mbretëri u takonte vetëm serbëve, sllovenëve dhe kroatve. Këta të fundit ishin fuqizuar në dëm të serbëve, si pasojë e raportit të ri të forcave në **Evropë** të krijuar pas ardhjes së Adolf Hitlerit në pushtet në vitin 1933. Në veçanti kroatët tani kishin fituar simpatitë e vendeve si **Gjermania** dhe **Italia,** të cilat e bënin ligjin ndërkombëtar në atë kohë dhe fuqishëm kundërshtonin rendin ndërkombëtar të krijuar në **Versajë** pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore. Ky raport ka prodhuar krijimin e **Banovinës Kroate.**

[45] Fjala është për dokumentet si vijon:
- **Deklarata e Kombeve të Bashkuara,** datë 1 janar 1942;
- **Deklarata e Moskës**, datë 30 tetor 1943 dhe Tehranit të datës 1 dhjetor 1943
- **Karta e Kombeve të Bashkuara**, datë 24 tetor 1945.

kishte ndodhur me **Shqipërinë** dhe vendet tjera që kishin humbur pavarësinë e sovranitetin si pasojë e ndërhyrjes ushtarake gjatë **Luftës së Dytë Botërore**.

Ajo çfarë po ndodhte me **Jugosllavinë** gjatë kësaj lufte dhe menjëherë pas saj, në fakt, nuk ishte asgjë tjetër pos një transformim i saj në aspektin kushtetues. Ky transformim konsistonte në kalimin nga rregullimi shtetëror monarkik në një rregullimin shtetëror socialist, me ideologjinë komuniste si avangardë e re. Ideologjia komuniste po zëvendësonte **integralizmin jugosllav** të proklamuar nga mbreti serb. Integralizmi në fjalë, nuk do të bazohej më në ideologjinë serbe të dinastisë **Karagjorgjeviq**, që shihte një popull me tre emra, përkatësisht një popull dhe një kurorë jugosllave, por në ideologjinë komuniste. Në atë kohë, komunizmi pretendonte një karakter universal dhe po përhapej ndër popujt tjerët jo-rus të Evropës dhe Azisë Qendrore.

Rregullimi i ri shtetëror komunist jugosllav do të zgjasë aq sa vetë formacioni në fjalë, i cili më pas u përhap në katër anët e botës, në veçanti pas procesit të dekolonizimit të viteve ’50 dhe ’60 të shekullit të kaluar. Ky formacion përfundoi me kolapsin e rendit komunist në fund të viteve ’90 të shekullit të kaluar, përkatësisht me rënien e **Murit të Berlinit** në nëntor të vitit 1989, i cili merret si simbol i ribashkimit të **Evropës.**

Në vijim të arsyeve si më sipër, diskutimi që pason në vijim të këtij seksioni ka të bëjë me zhvillimet me rëndësi kushtetuese gjatë dhe pas **Luftës së Dytë Botërore**. Në këtë kontekst, analiza jonë nis me dokumentet kryesore kushtetuese të kësaj periudhe, të cilat u listuan më sipër. **Sa i përket Kosovës, zhvillimet kushtetuese kanë kuptim vetëm pas amendamenteve të viteve 1969, 1971 dhe 1972 dhe miratimit të Kushtetutës së KSAK në vitin 1974 dhe pas saj**.

Koha e viteve 1945-1969 ka qenë një periudhë gjatë së cilës **Kosova** nuk ka gëzuar ndonjë status të theksuar juridiko-kushtetues sepse është trajtuar si pjesë ekskluzive dhe integrale e **Republikës së Serbisë**, e cila ka qenë njësi federale e **RSFJ**. Identiteti kushtetues i Kosovës në kuadër të **RSFJ** ka marrë formë të plotë vetëm pas vitit 1974. Në këtë vit është miratuar kushtetuta e parë e Kosovës, **Kushtetuta e KSAK.**[46] Me këtë kushtetutë, **Kosova** fitoi një status të veçantë juridik-kushtetues, shumë të ngjashëm më atë të ish-republikave jugosllave.[47] Që nga viti 1974, **Kosova** dhe **Vojvodina** (kjo e fundit ende është pjesë autonome në Serbinë e Veriut) filluan të gëzonin statusin e autonomisë politiko-territoriale, ashtu siç e kishte predikuar **Stalini** dhe teoria e praktika komuniste.[48]

Dokumenti i parë me rëndësi kushtetuese i nxjerrë gjatë **Luftës së Dytë Botërore** është **Rezoluta mbi themelimin e Këshillit Anitifashist të Çlirimit Kombëtar të Jugosllavisë** (KAÇKJ) e datës 27 nëntor 1942. Kjo rezolutë, e nxjerrë në **Bihaç** të **Bosnje - Hercegovinës**, nis bazat e para të ristrukturimit kushtetues komunist të ish-Jugosllavisë në baza federale. Kjo është kështu për shkak se organizimi, platforma e punës dhe tërë veprimtaria e mëvonshme e **KAÇKJ** kanë qenë të dirigjuara nga komunistët.

Në mbledhjen e **KAÇKJ** si më sipër u vendos që parimi federal dhe barazia e kombeve të ishin themeli i rregullimit të ardhshëm shtetëror të ish-**Jugosllavisë**. Kombësitë, siç quheshin atëherë pakicat kombëtare, fare nuk përmenden si subjekte të shtetit të ri federal. Me kombësi nënkuptoheshin pakicat kombëtare. Ky term qe farkuar nga komunistët për të treguar specifikat e sistemit komunist jugosllav. Në këtë

---

[46] Disa studiues mendojnë në mënyrë të gabuar se **Kosova** ka pasur identitet politik dhe kushtetues para vitit 1974, përkatësisht gjatë kohës së **Përandorisë Otomane** dhe **Mbretërisë SKS/Jugosllave** (sic!). Cf. më shumë lidhur me pikëpamjet kritike të kësaj pozite absurde të këtyre studiuesve kosovarë në Noel Malcolm, *Kosovo. A Short History* (New York University Press: New York, 1998), “Introduction” dhe fq. 314-333; Për natyrën e vilajeteve otomane dhe krijimin e tyre, cf. më shumë në Donald Quataret, *The Ottoman Empire 1700-1922* (Cambridge University Press: Cambridge, 2005), kapitulli 3 (“Chapter 3. The Ottoman Empire, 1683-1798”).

[47] Mari-Žanin Čalić, *Istorija Jugoslavije u XX veku*, fq. 319-322.

[48] Për një pasqyrë të mrekullueshme të historisë kushtetuese të Kosovës para vitit 1974, Cf. Kurtesh Salihu, *Lindja, zhvillimi, pozita dhe aspektet e autonomitetit të Krahines Socialiste Autonome të Kosovës në Jugosllavinë Socialiste* (Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mesimore i KSAK: Prishtine, 1984) fq. 7-63; Historia e konceptit të **autonomisë politico-territoriale** ashtu siç është shtruar nga **Stalini** sqarohet tek Michael Krykov, “Self-Determination From Marx to Mao” *Ethnic and Racial Studies* Vol. 19 No. 2 (April 1996) fq. 352-377.

grup hynin, në rend të parë, shqiptarët dhe hungarezet, për shkak se si pikë referimi merrej pasja e një shteti amë e që në këtë rast ishin **Shqipëria** e **Hungaria**.

Dokumenti i dytë me rëndësi kushtetuese është **Deklarata e Mbledhjes së Dytë të KAÇKJ** e datës 29 nëntor 1943, mbajtur në qytetin **Jajce** të **Bosnje-Hercegovinës**. Në këtë mbledhje u konstatua se gjatë **Luftës së Dytë Botërore** ka ardhur deri te ndryshimi i raportit të forcave dhe se kjo duhet të reflektohet në mënyrë të përshtatshme në lidershipin administrativ dhe shtetëror. Kjo ka ndodhur si pasojë e dështimit ushtarak të hegjemonisë serbe, gjë që ka krijuar kushtet për krijimin e një shteti demokratik në baza federative të popujve sllav të ish-Jugosllavisë. Organet e krijuara nga kjo mbledhje morën vendim që t'i ndalohet hyrja në shtet mbretit serb **Petri i Dytë Karagjorgjeviq**. Këto organe kanë qenë kuvendi dhe qeveria, si përfaqësues të sovranitetit të popullit dhe shtetit të Jugosllavisë, si organe të përkohshme, si dhe vetë kryesia e **KAÇKJ**-së.[49]

Vendimet e mbledhjes së dytë të **KACKJ** kanë karakter të pastër kushtetues sepse me këto vendime dhe me organet e themeluara është bërë ndërprerja e kontinuitetit kushtetues me ish- Jugosllavinë e para **Luftës së Dytë Botërore**. Kontinuiteti shtetëror juridik- ndërkombëtar me shtetin pararendës, ndërkaq, ka ngelur tërësisht i paprekur deri në shkatërrimin e tij në vitin 1992.

I treti dokument me rëndësi kushtetuese është **Marrëveshja Tito-Shubashiq** e lidhur në **Beograd** më datën 1 nëntor 1944.[50] Me këtë marrëveshje, diktatori komunist jugosllav **Josip Broz Tito** (1892-1980), në emër të qeverisë së përkohshme të **KAÇKJ**-së, dhe **Ivan Shubashiq** (1892-1955), në emër të qeverisë mbretërore jugosllave në mërgim, ranë dakord që t'i ndalohet mbretit **Petri i Dytë Karagjorgjviq** kthimi në atdhe. Ndalesa është dashur të zgjasë deri në një vendim tjetër të popujve të Jugosllavisë dhe derisa të bëhej formimi i një qeverie të përbashkët të përkohshme me një përbërje specifike.

Në bazë të kësaj marrëveshjeje dhe rekomandimeve të **Konferencës së Krimesë** të datës 7 mars 1945, u bë formimi i qeverisë së përkohshme të **RDFJ**. Me këtë merr fund dualizmi i qeverisë së mëparshme të formuar nga përfaqësuesit mbretërorë dhe komunistët e diktatorit jugosllav **Tito**: në këtë datë themelohet qeveria e re nën udhëheqjen e **Titos**, kurse **I. Shubashiq** bëhet ministër i Jashtëm i Jugosllavisë. Megjithatë, udhëheqja e re nën Titon, në këtë fazë nuk operon me terma komunist mbi luftën e klasave dhe diktaturën e proletariatit: në **Jugosllavi** u krijua një sistem i përzier politik, me elemente të parlamentarizmit liberal dhe shtetit njëpartiak të themeluar gjatë luftës.[51] Në të njëjtën kohë nis shndërrimi i **KAÇKJ**-së në një kuvend të përkohshëm me pushtet origjiner kushtetutëbërës (***pouvoir constituant***) të **Jugosllavisë Federative Demokratike**. Kjo ka ndodhur më datën 10 gusht 1945 dhe njihet si mbledhja e tretë e **KAÇKJ**-së, e mbajtur në **Beograd**.

Ky kuvend ka pasur në përbërjen e vet edhe anëtarë të parlamentit të vjetër mbretëror që nuk kishin bashkëpunuar me forcat naziste dhe qeveritë e krijuara nga gjermanët dhe italianët gjatë **Luftës së Dytë Botërore**. Në këtë mbledhje është marrë vendim për ndarjen e Sanxhakut në mes të **Serbisë** dhe **Malit të Zi** dhe bashkëngjitjen **Serbisë Federale** të Kosovës, si dhe mbajtjen e zgjedhjeve të reja në nëntor të atij viti. Pas zgjedhjeve është marrë vendim për themelimin e **RFPJ**.

Dokumenti i pestë, **Deklarata mbi shpalljen e RFPJ,** e nxjerrë më datën 29 nëntor 1945,[52] paraqet aktin e parë të kuvendit të përkohshëm me pushtet origjiner kushtetutëbërës (**Kuvendi Kushtetues**). Ai kuvend përbëhej nga dy dhoma: **Dhoma Federative** dhe **Dhoma e Popujve**. Ato dhoma kishin dalë nga zgjedhjet e nëntorit 1945 për Kuvendin Kushtetues. Deklarata përfundimisht abrogon monarkinë, kurse mbreti serb **Petri i Dytë** privohet nga çdo e drejtë lidhur me Jugosllavinë, si në planin e brendshëm

---

49 Për komentet, cf. në Dušan Papadopolos, *AVNOJ i narodno oslobodilačka borba u Bosni i Hercegovini: 1942-1943: materijali sa naučnog skupa održanog u Sarajevu 22. i 23. novembra 1973. godine* (Rad:Beograd, 1974).

50 Për tekstin e plotë, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavna_ navigacija /leksikon _jugoslavije/konstitutivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 nëntor 2017); Për komentet, cf. në Wayne S. Vucinich, Jozo Tomasevich, *Contemporary Yugoslavia: Twenty Years of Socialist Experiment* (University of California Press: Berkeley and Los Angeles, 1969) fq. 105, 108, 121.

51 Cf. Mari-Žanin Čalić, *Istorija Jugoslavije u XX veku*, fq. 218.

52 Për komentet, Cf. Branimir M Janković, *The Balkans in International Relations* (Mcmillan Press: London, 1988) fq. 180-181.

ashtu dhe në atë ndërkombëtar.[53] Në esencë, shpallja e regjimit republikan ka nënkuptuar shkëputje të tërësishme dhe rrënjësore me subjektivitetin juridik-kushtetues të Jugosllavisë mbretërore, që kishte ekzistuar gjatë viteve 1943-1945 si pasojë e rrethanave ndërkombëtare nën të cilat ishte gjetur **Jugosllavia**. Deklarata, përveç kësaj, proklamonte barazinë e të gjithë popujve të Jugosllavisë, të cilët thuhej se me vullnet të lirë kishin vendosur të jetojnë të bashkuar në Jugosllavi. Sa u përket pakicave kombëtare, siç ishin **hungarezët** dhe **shqiptarët**, as që bëhej fjalë sepse nuk konsideroheshin popuj me të drejtë për vetëvendosje të jashtme. Sistemi politik jugosllav tani e tutje në tërësi dhe në mënyrë efektive u bë njëpartiak, përkatësisht sistem në të cilin garantohej në mënyrë efektive supremacia (epërsia) e partisë komuniste dhe ideologjisë së saj.[54]

Me **Kushtetutën e RFPJ,** e miratuar më 31 janar të vitit 1946, si dokument i gjashtë me radhë, konfirmohet sanksionimi i tërësishëm i supremacisë (epërsisë) së **Partisë Komuniste Jugosllave** (PKJ).[55] Në të njëjtën kohë, ky dokument paraqet kushtetutën e parë të Jugosllavisë komuniste, në tërësi e modeluar sipas **Kushtetutës së Bashkimit të Republikave Sovjetike Socialiste** (BRSS) të vitit 1936. Kjo vërehet, në veçanti, në rolin dhe pozitën e organeve shtetërore në nivel federal, të cilat reflektonin një centralizëm të plotë të pushtetit, tipik për një vend stalinist, ku organet e njësive federale iu nënshtroheshin tërësisht organeve federale, në secilin aspekt të organizimit të pushtetit shtetëror. Kushtetuta përcaktoi që kufijtë republikanë do të caktoheshin më pastaj, pasi të merrej pëlqimi i republikave federale, kurse pakicat fituan disa të drejta kulturore dhe gjuhësore. Ky përcaktim për kufijtë u bë me qëllim që kufijtë e brendshëm ndër-republikanë mos të mund të ndryshoheshin pa pëlqimin e republikave. Prona më e fuqishme tani e tutje do të ishte prona shtetërore, së bashku me format tjera të pronës joprivate. Të gjitha këto zgjidhje kushtetuese ishin tipike për një vend stalinist sepse modeloheshin në tërësi sipas përvojës sovjetike të kohës.

Si organ kryesor i pushtetit lajmërohet **Kuvendi Federativ**, i përbërë nga dy dhoma, kurse vetë pushteti nuk ishte e ndarë por unik: parimi i unitetit të pushtetit ishte kategori kushtetuese, jo vetëm ideologjike, dhe përbënte premisën bazë dhe përcaktuese mbi natyrën dhe origjinën e pushtetit. Në këtë kontest, as që mund të bëhet fjalë për ndonjë kontroll gjyqësor të kushtetutshmërisë së ligjeve. Në këtë kohë, megjithatë, shfaqen shenjat e para të këtij instituti, njëjtë si në ish-**BRSS**: kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjeve ka qenë kryekëput politik sepse është kryer nga organi udhëheqës i kuvendit, **presidiumi**, para miratimit të tyre. Kjo do të thotë se këtu ka ekzistuar kontrolli preventiv politik i kushtetutshmërisë së ligje me qëllim të rishikimit nëse ato cenonin ndonjërin prej postulateve komuniste ashtu siç kuptoheshin ato nga ana **PKJ.**

Ligji Kushtetues i vitit 1953, paraqet dokumentin e shtatë me rëndësi të madhe kushtetuese, ani se nuk ka qenë një kushtetutë e plotë. Ndryshimet e thella politike dhe shoqërore të viteve 1946 – 1953 kanë pasur për pasojë nxjerrjen e këtij ligji, me të cilin Kushtetuta e vitit 1946 është ndryshuar në masë të madhe. Në rend të parë, pushteti tani e tutje nuk i takon popullit, por kategorisë së re të popullit punues, kurse Jugosllavia definohet si shtet federativ socialist dhe demokratik i popujve sovranë dhe të barabartë. Në rend të dytë, pronësia shoqërore mbi mjetet e prodhimit, **vetëqeverisja** e prodhuesve në ekonomi, e popullit punues në komunë, qytet dhe rrethe proklamohet si bazë e shtetit të ri socialist. Organ më i lart i pushtetit sërish ngelet **Kuvendi Federativ.** Në nivel republikan, një status të tillë e gëzojnë kuvendet republikane. Në vend të presidiumit, si organ kolektiv udhëheqës dhe ekzekutiv, u krijua institucioni i presidentit të republikës, i cili në të njëjtën kohë ishte kryetar i qeverisë dhe i shtetit.[56] Edhe në këtë fazë nuk mund të flitet për ndonjë përvojë të veçantë në lëmin e kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë.

Dhjetë vjet pas nxjerrjes së **Ligjit Kushtetues**, më datën 7 prill 1963, u nxor **Kushtetuta e RSFJ,** emër i ri kushtetues të cilin do ta mbajë deri në shpërbërjen e vet përfundimtare në pranverë të vitit 1992. Ky

---

53 Në aspektin e pluralizmit politik, kjo deklaratë shënon kalimin e Jugosllavisë në sistemin kushtetues njëpartiak: tani e tutje nuk lejohet më ekzistimi i asnjë partie politike përveç partisë komuniste jugosllave. Cf. Mari-Žanin Čalić, *Istorija Jugoslavije u XX veku*, fq. 219.

54 Ibid. fq. 219.

55 Ibid. fq. 220.

56 Ibid. fq. 243-252.

dokument kushtetues, i teti me radhë, ndryshe është cilësuar edhe si **karta e vetëqeverisjes** sepse modeli i vetëqeverisjes socialiste, si simbol i shkëputjes nga rruga staliniste e planifikimit shtetëror të ekonomisë dhe dominimit të shtetit në të gjitha sferat e jetës, u zëvendësua me këtë model të ri të qeverisjes në të gjitha sferat e jetës shoqërore.[57] Kjo pati efekte në zhvillimin e shpejt ekonomik të vendit.

Ndryshimi i emrit pat refleksione edhe në definimin e shtetit: tani e tutje **RSFJ** cilësohet si një shtet federativ i popujve të barabartë të bashkuar me vullnet dhe si një bashkësi socialiste demokratike e bazuar në pushtetin e popullit punues dhe vetëqeverisjen.[58] Me këtë kushtetutë, **Kosova** fiton një ngritje në statusin e saj juridik-kushtetues: nga një rreth autonom shndërrohet në një krahinë autonome, ani se me të drejta më të vogla se Vojvodina, e cila gjithashtu ishte në kuadër të Serbisë, që konsiderohej si njësi federale (krahas **Bosnje-Hercegovinës, Kroacisë, Maqedonisë, Malit të Zi** dhe **Sllovenisë**).

Kushtetuta për herë të parë parashikon themelimin e **Gjykatës Kushtetuese të RSFJ** dhe gjykatave kushtetuese republikane. Kjo ndodhë për herë të parë në një vend komunist dhe paraqet arritje të madhe për kohën.

Në literaturë janë dhënë dy arsye kryesore që kanë shkaktuar themelimin e kësaj gjykate, e cila në tërësi është modeluar sipas konceptit **evropian/kelsenian**. Ato arsye janë për sa vijon:

- e para, futja e vetëqeverisjes si një sistem i ri qeverisës që dukshëm dallonte nga të gjitha vendet tjera ish-komuniste në të cilat shteti dhe aparati shtetëror dominonin të gjitha sferat e jetës,[59] dhe,
- e dyta, fuqizimi i rolit dhe pozitës së individit në një sistem socialist që bazohej në këtë model qeverisës, që thuhej se ishte më e favorshme krahasuar me vendet tjera të universit komunist sepse kishte një "fytyrë humane".[60]

Kuvendi edhe në këtë periudhë vazhdon të ngelet si organ më i lartë i pushtetit, pushtet që gjithnjë gjatë tërë kohës së ekzistimit të **RSFJ** është cilësuar si unik dhe i pandarë dhe që i ka takuar njeriut punues socialist dhe vetëqeverisës. Nuk ndryshonte asgjë fakti se tani në Kuvendin Federativ ishin krijuar pesë dhoma për të reflektuar diversitetin e ndryshëm të shtetit të përbashkët jugosllav që bazohej në vullnetin e ish republikave për të jetuar së bashku në atë shtet.

Amendamentet në Kushtetutën e vitit 1963 përbëjnë hyrje në revidim të tërësishëm të kësaj të fundit. Këto amendamente janë miratuar përgjatë viteve 1967, 1968 dhe 1971. Me to është forcuar roli i republikave dhe i krahinave autonome. Këto të fundit thuajse janë barazuar në statusin e tyre juridik-kushtetues me republikat federale, kurse vetë Federata u bë një forum konsensusi në mes të republikave dhe krahinave. Tani e tutje republikat dhe krahinat bëhen akterë kryesor të **RSFJ** ashtu që çdo veprim i Federatës për çështjet kryesore i nënshtrohej marrëveshjes konsensuale në mes të republikave dhe krahinave.[61]

Në një situatë të tillë vjen edhe deri të formimi i gjyqësisë kushtetuese në Kosovë, pra në vazhdën e forcimit të rolit dhe pozitës së Kosovës në kuadër të federatës jugosllave. Marrëdhëniet e reja, të siguruara me **amendamentet kushtetuese federale** të vitit 1968, të cilat siguronin pozitën e re të **Kosovës**

---

57 Në literaturë, ky dokument cilësohet si një tekst i një vendi komunist që për herë të parë në kuadër të sistemit komunist të kohës ka filluar një interpretim më liberal të doktrinës marksiste–leniniste rreth ekonomisë dhe proceseve shoqërore: vetëqeverisja dhe decentralizimi ishin dy komponente të komunizmit jugosllav, të cilat i jepnin sistemi politik dhe kushtetues një "fytyrë humane" krahasuar me vendet tjera të bllokut komunist. Cf. Dimitar Bechev, *Rival Power. Russia's Influence in South East Europe* (Yale University Press: New Haven and London, 2017) fq. 25-2

58 Cf. Mari-Žanin Čalić, *Istorija Jugoslavije u XX veku*, fq.234-252.

59 Dimitrije Kulic, *Ustavno sudstvo u svetu*. Drugo Izdanje (Leskovac, 1972) fq. 157-161.

60 Në literaturë, kjo kushtetutë cilësohet si një tekst i një vendi komunist që për herë të parë në kuadër të sistemit komunist të kohës ka filluar një interpretim më liberal të doktrinës marksiste – leniniste rreth ekonomisë dhe proceseve shoqërore: vetëqeverisja dhe decentralizimi ishin dy komponente të komunizmit jugosllav të cilat i jepnin sistemi politik dhe kushtetues një "ftyrë humane" krahasuar me vendet tjera të bllokut komunist. Cf. Dimitar Bechev, *Rival Power. Russia's Influence in South East Europe*, fq. 25-26; Për fuqizimin e rolit të individidt si arsye e dytë për krijimin e gjqyësisë kushtetuese jugosllave krahas arsyes që lidhet me rendin objektiv kushtetues të sanksionuar me kushtetutë, cf. poashtu edhe te Dimitrije Kulic, *Ustavno sudstvo u stevu*, fq. 160.

61 Cf. Mari-Žanin Čalić, *Istorija Jugoslavije u XX veku*, fq. 284-285 & 293-313.

në sistemin kushtetues të **RSFJ**, kanë ndikuar në zgjerimin e autonomitetit të **Kosovës** si krahinë autonome, përfshirë këtu të drejtën e saj që, nëpërmjet organit të vet, të mbrojë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë.[62] Prej këtij viti mund të flitet për kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë kosovare, sepse **KSAK** fitoi të drejtën për të nxjerrë ligjin kushtetues (në vend të statutit të deriatëhershëm, i cili kishte qenë akti më i lartë juridik në Kosovë) dhe ligje (në vend të vendimeve, të cilat kishin qenë aktet më të larta në vend pas statutit). Në këtë mënyrë, funksionin e mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë nëpërmjet mekanizmit të gjyqësisë kushtetuese **Kosova** fillon ta ushtrojë pas nxjerrjes së **Ligjit Kushtetues të KSAK** në vitin 1969 (Ligji i vitit 1969), nëpërmjet **Degës së Posaçme Kushtetuese** pranë **Gjykatës së Lartë të KSAK (Dega e Posaçme).**[63]

Juridiksioni, palët e autorizuara dhe natyra e vendimeve të kësaj dege rregulloheshin me nenet 147 – 152 ["Gjykata e Lartë e Kosovës"] të Ligjit të vitit 1969.

Sipas nenit 147, Dega e Posaçme vendoste:

- vendoste mbi përputhshmërinë e ligjeve krahinore me Ligjin e vitit 1969;
- vendoste mbi përputhshmërinë e dispozitave të tjera krahinore, dispozitave komunale dhe akteve të përgjithshme të organizatave punonjëse dhe organizatave të tjera vetëqeverisëse me Ligjin e vitit 1969 dhe ligjin krahinor;
- kryente edhe punë të tjera që ishin lënë në kompetencën e saj me ligj krahinor.

Sipas paragrafit të fundit të këtij neni, **Dega e Posaçme** kishte për detyrë që të përcillte dukuritë me interes për realizimin e kushtetutshmërinë e ligjshmërinë dhe për këto dukuri njoftonte **Kuvendin e KSAK**, duke i dhënë atij mendime e propozime për nxjerrjen e ligjeve krahinore dhe për marrjen e masave përkatëse. Sikundër është diskutuar në kontekstin ish-jugosllav, një kompetencë të tillë e kanë pasur të gjitha gjykatat kushtetuese republikane dhe Gjykata Kushtetuese e RSFJ. Edhe pas rrënimit të komunizmit dhe pavarësimit të tyre, disa nga ish-republikat jugosllave e kanë ruajtur këtë lloj të detyrimit kushtetues kundrejt dukurive të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. **Kosova** nuk e ka bërë një gjë të tillë.

Si palë të autorizuara për t'u paraqitur pranë këtij organi kushtetues kanë qenë të gjitha organet e pushtetit qendror në **KSAK**, individët, organizatat punuese dhe organizatat tjera vetëqeverisëse dhe, në fund, vetë **Dega Kushtetuese** mund ta vente në lëvizje procedurën **sua sponte**, me vetiniciativë. Sikundër shihet, ky juridiksion dhe palët e autorizuara janë të ngjashme me ato që kanë pasur gjykatat kushtetuese republikane, **Gjykata Kushtetuese e RSFJ** dhe, më vonë nga viti 1972, vetë **Gjykata Kushtetuese e KSAK**.[64]

E njëjta vlen edhe për **natyrën juridike** të vendimeve të saj: nëse Kuvendi i KSAK brenda gjashtë muajsh nga dita e nxjerrjes së vendimit që konstatonte mospërputhje të ligjit krahinor me Ligjin e vitit 1969, nuk kryente harmonizimin e të parit me të dytin, atëherë ai ligj apo ajo dispozitë dilnin nga fuqia (shfuqizoheshin). Këtë dalje nga fuqia duhej ta konstatonte, sipas paragrafit të dytë të nenit 149 të Ligjit të vitit 1969, **Gjykata e Lartë e KSAK** me vendimin e vet përfundimtar.

Në paragrafin në vijim të nenit të njëjt flitej për vënien e masave të përkohshme ndaj zbatimit të ligjit si tërësi apo ndaj dispozitave të tij përkatëse, të cilat me vendim të **Degës së Posaçme** janë shpallur si të papajtueshme me Ligjin e vitit 1969. Sikundër shihet, në këto raste nuk bëhej fjalë për anulim (abrogim)

---

62 Për trajtimin më shterrues dhe të thellë të autonomisë së Kosovës në ish-Jugsollavi, cf. monografinë e prof. **Kurtesh Salihu** në fusnotën 48, **supra**, në këtë seksion, si dhe tekstin që e shoqëron.

63 Ligji i parë kushtetues i KSAK është nxjerr në vititn 1969. Cf. **Ligja Kushtetuese e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës**, botuar në *THGB Fletorja Zyrtare e KSAK*. Prishtinë (1969). Në këtë botim është dhënë edhe fjala e **Fadil Hoxhës**, funksionarit kryesor komunist të **Kosovës**. Në këtë fjalë hyrëse, shprehet entuziazmi e madh i tij dhe gjeneratës së kohës për nxjerrjen e këtij ligji dhe shfuqizimin e **Statutit të Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë**. Kjo sepse, Statuti ishte një akt juridik i dobët që derivonte nga vullneti i **Republikës së Serbisë** dhe ishte pjesë përbërse e vetëqeverisjes lokale të llojit komunist të kohës, kurse Ligji Kushtetutes sanksiononte një autonomi politiko-territoriale, po ashtu të tipit komunist, por me një përmbajtje dukshëm me të avansuar dhe që nuk bënte pjesë në vetqeverisjen lokale. Cf. për këtë më shumë në librin monografik të prof. **Kurtesh Salihu**, fusnota 48, **supra**, në këtë seksion.

64 Ibid., fq. 141.

të ligjit apo dispozitave të tij konkrete, të cilat me vendim janë shpallur si të papajtueshme me Ligjin e vitit 1969: një gjë e tillë parashikohej vetëm për aktet e tjera të përgjithshme më të ulëta se ligji. Kjo qartë përcaktohej në paragrafin e katërt dhe të fundit të nenit 149 të Ligjit të vitit 1969.

Efekti i vendimeve është normuar me nenin 150 të Ligjit të vitit 1969, i cili në një paragraf të vetëm fliste për një gjë të tillë. Aty përcaktohej se çdo vendim që interpreton një normë të tij apo të ndonjë ligji tjetër, si dhe normat e ndonjë akti të përgjithshëm, atëherë ai vendim ka fuqinë e njëjtë me te, përkatësisht me ligjin e zakonshëm.

Në juridiksion të Degës të Posaçme nuk ka qenë kontrolli **incidental i kushtetutshmërisë**, për arsye krejt normale dhe të natyrshme: fakti që ajo, njëjtë si të gjitha gjykatat kushtetuese republikane dhe **Gjykata Kushtetuese e RSFJ**, me vonë edhe **Gjykata Kushtetuese e KSAK**, ka pasur të drejtën e vënies në lëvizje të vetvetes me vetiniciativë, **sua sponte**, juridiksioni incidental i këtyre gjykatave nuk do të kishte pasur asnjë kuptim.

Zgjerimi i funksioneve legjislative të Kosovës, me ndryshimet kushtetuese të vitit 1971, shkoi edhe më tutje, duke ndikuar në organizimin e saj më të avancuar në sferën e ushtrimit të funksionit të saj në mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Avancimi vendimtar, megjithatë, u bë vitin në vijim me amendamentin e vitit 1972 në Ligjin e vitit 1969. Me këto akte u bë themelimi i **Gjykatës Kushtetuese të KSAK**, si organ i pavarur për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në tërë territorin e Kosovës.

Kushtetuta e RSFJ e vitit 1974 nuk bën gjë tjetër pos që sanksionon të arriturat e kryera me amendamentet në Kushtetutën e vitit 1963, pra, forcon rolin e republikave dhe krahinave, duke dobësuar në të njëjtën kohë rolin e Federatës. Çdo gjë në nivel federal, tani e tutje duhej të realizohej përmes marrëveshjes në mes të republikave dhe dy krahinave autonome, pra jo në mes të popujve siç pretendonin serbët.[65]

Kjo fizionomi u reflektua edhe në organet e reja kushtetuese: **Kuvendi i RSFJ** u bë dydhomësh, njëra dhomë për përfaqësim të popullit punues vetëqeverisës, të qytetarëve dhe shtresave të tjera, kurse dhoma tjetër shërbente si përfaqësuese e republikave dhe krahinave në mënyrë të barabartë. Në bazë të kësaj kushtetuese, **Kosova** fiton të drejtën e nxjerrjes së kushtetutës së vet në mënyrë autonome, njëjtë siç e kishin gëzuar këtë të drejtë republikat jugosllave. Me **Kushteutën e KSAK të datës 28 shkurt 1974** (Kushtetuta e vitit 1974), pozita e **Gjykatës Kushtetuese të KSAK** nuk ndryshon, përveç se ajo pavarësohet edhe më tepër: vetë fakti që **Kosova** tani nxjerr kushtetutën e vet, si akt më i lartë politiko-juridik, e zgjeron dukshëm bazën e aktivitetit të këtij organi.

Në bazë të Kushtetutës së vitit 1974, **Gjykata Kushtetuese e KSAK** ka pasur juridiksion:[66]

- për të vendosur mbi pajtueshmërinë e ligjeve krahinore me **Kushtetutën e KSAK**;
- për të vendosur mbi pajtueshmërinë e statuteve të komunave me **Kushtetutën e KSAK** dhe ligjin krahinor;
- për të vendosur mbi pajtueshmërinë e dispozitave dhe të akteve të tjera të përgjithshme të organeve shtetërore, të organizatave të punës së bashkuar dhe të organizatave të bashkësive të tjera vetëqeverisëse me **Kushtetutën e KSAK**, me ligjin krahinor dhe me dispozitat tjera krahinore, me ligjin republikan me të cilin rregullohen me marrëveshje për territorin e **Republikës së Serbisë** (dmth përfshirë këtu **KSA të Kosovës**, e cila atëherë, në aspektin kushtetues, ka qenë pjesë përbërëse e saj), si dhe mbi atë se a janë këto akte në kundërshtim me ligjin federative, për zbatimin e të cilit janë përgjegjëse organet në **KSA të Kosovës**;
- për të vendosur mbi pajtueshmërinë e dispozitave të organeve të **KSA të Kosovës** të nxjerra për zbatimin e ligjeve të **Republikës së Serbisë,** të cilat aplikoheshin në tërë territorin e Republikës;
- për të zgjidhur konfliktet mbi të drejtat dhe detyrat midis Krahinës dhe komunave në territorin e **Kosovës**, si dhe konfliktet midis dy a më shumë komunave në të njëjtin territor, në qoftë se për zgjidhjen e konflikteve të tilla nuk është parashikuar me ligj kompetenca e gjykatës tjetër;

---

65 Mari-Žanin Čalić, *Istorija Jugoslavije u XX veku*, fq. 320-322.

66 Neni 372 [“Gjykata Kushtetuese e Kosovës”] i **Kushtetutës së KSA të Kosovës.**

- për të vendosur për zgjidhjen e konflikteve për kompetencë midis gjykatave dhe organeve tjera në **KSA të Kosovës**;
- për të kryer edhe punë tjera që i janë lënë në kompetencë me Kushtetutë.

Në nenin 373 ["Gjykata Kushtetuese e Kosovës"] të Kushtetutës parashikohej detyra e saj për të përcjellë dukuritë me interes për kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë krahinore dhe të informonte **Kuvendin e KSAK** për gjendjen e këtyre dukurive me interes. Në këtë kontekst, ajo ka pasur të drejtë që Kuvendit t'i propozojë nxjerrjen dhe ndryshimin e ligjeve të caktuara dhe marrjen e masave me qëllim të sigurimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë krahinore dhe mbrojtjes së të drejtave e lirive të vetëqeverisjes dhe ato qytetare të individëve dhe organizatave e bashkësive vetëqeverisëse.

Autorizimet për përcjelljen e dukurive dhe informim të **Kuvendit të KSAK** për to kanë qenë të ngjashme për të gjitha gjykatat kushtetuese republikane dhe krahinore dhe për **Gjykatën Kushtetuese të RSFJ**, u mor vesh në domenin e kushteutshmërisë dhe ligjshmërisë brenda territorit respektiv të secilës prej tyre. Kjo, siç e kemi thënë në kapitullin e pestë, paraqet një relikt të ish-sistemit socialist, të cilin disa nga gjykatat kushtetuese të ish-republikave jugosllave e kanë ruajtur deri në ditët e sotme.

Në vijim të diskutimit si më sipër lidhur me cilësitë e përbashkëta të gjyqësisë kushtetuese kosovare në kohën **Jugosllavisë** socialiste, në kuptim të "konstitucionalizmit" të kohës, Kosova ka pasur cilësi që kanë qenë të njëjta me ato të shtetit të cilit i ka takuar.

Socializmi jugosllav, përkundër faktit se ka pasur një "fytyrë humane" në krahasim me vendet tjera komuniste, në esencë ka ngërthyer cilësi që kanë qenë të përbashkëta për të gjitha vendet e universit komunist në **Evropë** dhe më gjerë. Këto cilësi, në rend të parë, kanë pasur të bëjnë me sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut të garantuara me kushtetutë, të cilat iu janë nënshtruar interesave të klasës punuese dhe fshatarësisë të udhëhequra nga PKJ (më vonë riemëruar në "Lidhja Komuniste e Jugosllavisë" apo **LKJ**).[67] Në këtë kontekst, së dyti, ka qenë ligjshmëria socialiste dhe uniteti i pushtetit që ushtrohej nga partia komuniste në emër dhe për klasën punëtore dhe fshatarësinë që kanë gëzuar supremaci (epërsi) ndaj çdo gjëje tjetër, përfshirë këtu normat kushtetuese. Kjo nënkuptonte se asnjë individ nuk mund të gëzonte të drejta dhe liri njerëzore në dëm të këtyre vlerave, kësaj ligjshmërie socialiste dhe këtij uniteti socialist të pushtetit, i njohur ndryshe edhe si "diktatura e klasës punëtore".[68]

Gjykata Kushtetuese e KSAK (dhe ajo e **Vojvodinës**), njëjtë si gjykatat kushtetuese të njësive federale jugosllave dhe **Gjykata Kushtetuese e RSFJ**, i ka shërbyer ruajtjes së këtyre vlerave. Në fakt, vetë Kushtetuta e RSFJ e 1974 theksonte se liritë dhe të drejtat njerëzore garantohen me kushtetutë përveç nëse me ligj nuk përcaktohej ndryshe. Ky formulim, pra formulimi "përveç nëse me ligj nuk përcaktohet ndryshe", në mënyrë efektive i zhvlerësonte garancionet e dhëna kushtetuese lidhur me këto liri dhe të drejta individuale. Të gjitha gjykatat kushtetuese në **ish-Jugosllavi** ishin **evropiane/kelseniane** vetëm në formë: juridiksioni i tyre ka qenë e dizajnuar ashtu që ato të shërbenin vetëm si një instrument për ruajtjen e vlerave themelore të sistemit kushtetues socialist, i cili bazohej në supremacinë (epërsinë) e të drejtave kolektive të zhvillimit socialist, jo në mbrojtjen dhe promovimin e lirive dhe të drejtave individuale. Këto të fundit i nënshtroheshin diktatit të ligjshmërisë socialiste në tërësinë e tyre, për shkak se për ruajtjen e saj mund të bëhej kufizimi dhe cenimit i tyre në çdo kohë me anë të ligjit të zakonshëm.

---

67 Cf. Nenet 375-396 të **Kushtetutës së RSFJ** të vitit 1974 si dhe nenet korrepsonduese të kushtetutave të republikave ish-jugosllave dhe të dy krahinave autonome (Kosovës dhe Vojvodinës) të vitit 1974. Për tekstin e plotë të këtyre kushtetutave, shih në: *Ustav SRFJ. Ustavi socialistickih republika i pokrajina* ("Slobodna Dalmacija": Beograd, 1974); Për komentet në doktrinën jugosllave, shih në Jovan Gjorgjeviq, *E drejta kushtetuese* (Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mesimore i KSAK: Prishtine, 1972) fq. 279-332; 342-355; 770-801; Jovan Gjorgjeviq, *Sistemi politik. Kontribut shkencces mbi njeriun dhe vetqeverisjen* (Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mesimore i KSAK: Prishtine, 1978) fq. 606-625; 947-1006; 1110-1144.

68 Cilësia kryesore e "konstitutcionalizmit socialist", pjesë e të cilit ka qenë edhe **Kosova**, ka qenë akomodimi i tensionit bazik në mes të doktrinës komuniste mbi supremacinë e organit përfaqësues, Kuvendit, me doktrinën mbi unitetin e tërë pushtetit në të cilin partia komuniste shërbente si vangardë e klasës punëtore dhe e fshatarësisë në emër të të cilëve ai pushtet unik ushtrohej. Cf. më shumë në Paolo Carroza, "Il diritto socialista". In P. Carrozza, A. Di Giovine & G. F. Ferrari (eds.), *Diritto costituzionale comparato* (GLF Editori Laterza: Roma-Bari, 2009), pp. 583-615; Karl J. Fridrih, *Konstitucionalna Demokratija* (CID: Podgorica) fq. 47-50.

10.2. Periudha pas vitit 1974, ardhja në pushtet të diktatorit serb Slobodan Milosheviq dhe ndërhyrja ushtarake e NATO-së për të ndihmuar çlirimin e Kosovës

Përgjatë viteve '80 të shekullit të kaluar, Kushtetuta e RSFJ e vitit 1974 ka pësuar disa amendamentime. Reforma kushtetuese ndërmjet viteve 1981-1988, e realizuar përmes amendamenteve I – VIII dhe IX-XL-VIII nuk ka qenë e natyrës së atillë sa të prekë apo ndryshojë identitetin kushtetuese të shtetit jugosllav.

Të parat, të miratuara më 3 korrik 1981, përmbajnë parimet mbi punën kolektive, vendimmarrjen dhe përgjegjësinë, kurse të dytat, të miratuara më 25 nëntor 1988, kanë zgjeruar bazën e tregut të përbashkët jugosllav dhe të drejtat legjislative të Federatës. Me këto amendamente është ruajtur parimi i konsensusit në mes të republikave dhe krahinave autonome në nivel të Federatës. Thënë ndryshe, këto amendamente nuk kanë qenë substanciale sepse nuk kanë prekur dhe ndryshuar identitetin kushtetues dhe identitetin tjetër të atij shteti. Këto amendamente kishin për qëllim adresimin e dobësive dhe krizës jugosllave në lindje e sipër që nisi me vdekjen e diktatorit komunist **Tito**.

Ka qenë ardhja në pushtet në vitin 1986 e diktatorit serb **Sllobodan Milosheviq** që ndryshoi çdo gjë në nivel jugosllav: nga kjo kohë, në **Serbi** u hap "kutia e Pandorës" së nacionalizmit serb, i cili provokoi fuqishëm edhe nacionalizmat tjerë, në rend të parë atë kroat dhe slloven, por edhe nacionalizmat që deri atëherë kishin qenë të fjetur (maqedonët, muslimanët boshnjakë, hungarezët etj). Në mesin e shumë sllogane ve në retorikën nacionaliste serbe të kësaj kohë ka qenë rikthimi i shtetësisë së **Serbisë**, të cilën serbët e konsideronin se e kishin humbur me nxjerrjen e **Kushtetutës së RSFJ të vitit 1974**. Kjo humbje, gjithnjë sipas serbëve, konsistonte në atë se ajo kushtetutë ua kishte njohur dy krahinave autonome një pavarësi të madhe politiko-territoriale, të barabartë me statusin që e gëzonin republikat federale. Kjo, në fakt, kishte të bënte vetëm me **Kosovën**. **Vojvodinën** serbët asnjëherë nuk e kishin konsideruar rrezik për identitetin e tyre nacional: nga vitit 1945 e tutje serbët kanë arritur ta ndryshojnë në mënyrë radikale strukturën nacionale të popullsisë së saj në dobi të tyre duke margjinalizuar gjermanët, hungarezët dhe popujt tjerë që kishin jetuar në atë vend me shekuj të tërë gjatë kohës së **Perandorinë Austro-Hungarze**, por edhe para saj.

Kjo logjikë e nacionalizmit serb, me ardhjen në pushtet të **S. Milloshevi**q shkaktoi reagime dhe rezistencë të ashpër, si në nivel federal ashtu dhe në nivel të republikave jo serbe. Kjo vinte si pasojë e vetëdijes se një qasje e tillë serbe do t'i prishte balanset politike, nacionale, juridiko-kushtetuese, ekonomike dhe balanset tjera në nivel jugosllav, të cilat ishin përcaktuar me parametrat e **Kushtetutës së RSFJ** të vitit 1974. **Serbia** e diktatorit **S. Milosheviq**, përkundër gjithë këtij rreziku për prishjen e këtyre balansave, nisi një luftë frontale kundër të gjithëve me qëllim të ndryshimit të raportit të forcave në favor të saj: së pari rrënoi qeveritë kushtetuese në **Mal të Zi** dhe **Vojvodinë**, pastaj iu vërsul **Kosovës**, duke i kthyer për vete votat e katër njësive federale, me qëllim që më pastaj të kryente ndryshimet radikale kushtetuese në nivel federal. Një sjellje e tillë rrezikonte kroatët, maqedonasit dhe boshnjakët, përveç që bëri riintegrimin tërësisht të dhunshëm të **Kosovës** në sistemin kushtetues serb, i cili u krye në shtator të vitit 1990. Kjo u pasua, pas pak muajsh me sulme ushtarako-policore dhe me paramilitarë kundër sllovenëve, kroatëve dhe myslimanëve. Në ndërkohë, në **Kosovë** ai vuri gjendjen e përhershme të jashtëzakonshme, e cila zgjati deri në çlirimin e Kosovës më 10 qershor 1999 nga trupat e **NATO**-se, të ndihmuara nga forcat e **UÇK-së**.

Të gjitha këto ngjarje kanë ndodhur me intensitet të shtuar përgjatë viteve 1989-1990. Në këto dy vite të gjitha kushtetutat e republikave dhe krahinave pësuan ndryshime rrënjësore, të cilat nuk përputheshin fare me **Kushtetutën e RSFJ** të vitit 1974, për shkak se përmbanin dispozita që ishin jashtë parimeve dhe normave të saj, si në formë ashtu dhe në përmbajtje. Kjo rrugë kundërkushtetuese e rrënimit të shtetit të fundit të sllavëve të jugut (me përjashtim të bullgarëve), në mënyrë simbolike nis me **Kosovën**, aty ku kishte nisur kriza e atij shteti në fillim të viteve '90 të shekullit të kaluar.

Synimi serb për hegjemoni dhe dominim ka nisur në mënyrë të hapur që nga demonstratat e shqiptarëve të Kosovës që nisën më 11 mars 1981. Shtypja brutale e tyre dhe persekutimi masiv i shqiptarëve nuk patën të ndalur që nga kjo kohë. Ardhja në pushtet e **S. Milloshevi**q vetëm sa ka intensifikuar më shumë marrëdhëniet jashtëzakonisht konfliktuoze **Kosovë-Serbi.** Kjo pati refleksione të drejtpërdrejta në tërë **Jugosllavinë** dhe në marrëdhëniet e serbëve me popujt tjerë. Në fakt, reagimi slloven, kroat dhe, më vonë, edhe reagimi maqedonas e boshnjak në vigjilje të luftës dhe dhunës gjithë jugosllave kanë qenë reagime me qëllim të

pengimit të Serbisë për të vënë në jetë politikat e njëjta si ato që kishte zbatuar në **Kosovë** kundër popullsisë së saj shumicë që nga viti 1981.

Me ardhjen e tij në pushtet, diktatori serb mori si detyrë të shenjë reintegrimin e Kosovës dhe Vojvodinës në Serbi në të gjitha aspektet: politike, shoqërore dhe ekonomike, kulturore dhe në aspekte të tjera. Kjo, në fakt, përbënte realizim të politikës hegjemoniste serbe të skicuar në **Memorandumin e ASSHA** të vitit 1986 (Memorandumi), një dokument famëkeq të cilin, në fakt, vetë lideri serb **S. Millosheviq** e kishte kundërshtuar fillimisht.[69] Në ndërkohë që sulmi ndaj **Vojvodinës** edhe mund të kalonte pa ndonjë pengesë serioze, për shkak të ndërrimit radikal të përbërjes etnike të popullsisë atje, në **Kosovë** gjendja paraqitej krejt më ndryshe: reintegrimi i **Kosovës** në **Serbi**, sipas ideve të **Memorandumit të ASSHA,** mund të bëhej vetëm me përdorim të dhunës në një shkallë të gjerë dhe në mënyrë sistematike. E njëjta gjë vlente edhe për **Kroacinë** dhe **Bosnje-Hercegovinën**, për të cilat Memorandumi thoshte se kanë në gjirin e tyre serb që janë të persekutuar si qytetarë të rendit të dytë. Ky qëndrim u përkthye shumë shpejt në përdorim të dhunës, atëherë kur nisi zbatimi i tij në Kroaci dhe Bosnje – Hercegovinë gjatë viteve 1991-1995.

Pas demonstratave të popullsisë shqiptare në Kosovë në pranverë të vitit 1981, **Beogradi** hapur i bëri të qarta synimet e veta për ta rikthyer nën kontroll të plotë "krahinën e saj jugore", siç e quajnë serbët **Kosovën** sot e kësaj dite. Në këtë kohë, deri ma ardhjen e diktatorit **S. Millosheviq** në pushtet, serbët nuk kishin gjetur asnjë aleat serioz nga popujt ish-jugosllavë për t'i mbështetur në këtë përpjekje. Kjo sepse, siç vlerësohej atëherë nga të gjithë, një përpjekje e tillë nënkuptonte një transformim radikal kushtetues dhe politik të **RSFJ-së**, ashtu siç ishte projektuar ajo sipas parametrave të Kushtetutës së vitit 1974. Për këtë nuk ishin gati popujt tjerë, republikat dhe as vetë krahina e **Vojvodinës**. Kishte disa arsye pse kjo ishte kështu. Në rend të parë, raporti i brendshëm i forcave nuk shkonte në dobi të realizimit të këtij projekti nacional serb: popujt tjerë jugosllav e dinin se në çfarë gjendje kishte qenë Kosova para nxjerrjes së amendamenteve të viteve '70 dhe fillimit të viteve '80 të shekullit 20-të (1968 - 1972). Memzi ishte krijuar një balans i ri i forcave që ishte shumë i cenueshëm: prishja e balanceve të viti 1974, në mënyrë të qartë ishte bërë synim serb në Memorandum, i cili i paraqiste serbët si viktima të popujve tjerë të ish-Jugosllavisë, në rend të parë si viktima të shqiptarëve dhe kroatëve, të cilët cilësoheshin si popuj agresivë dhe fajtor për "gjenocidin kundër serbëve".[70]

---

[69] Për tesktin e plotë të Memorandumit, Cf. *Serbian Academy of Arts and Sciences (SANU) Memorandum 1986*. Në internet: http:// chnm. gmu. edu/ 1989/ items/sHow/674 (shikuar në dhjetor 2017); *Memorandum Srpske Akademije Nauka i Umetnosti (nacrt) Jesen 1986.* Në internet:http://www.helsinki.org.rs/serbian/doc/mem orandum%20sanu.pdf (shikuar në dhjetor 20017); Për komentet e tij, cf. Christina Morus,"The SANU Memorandum: Intellectual Authority and the Constitution of an Exclusive Serbian 'People'" *Communication and Critical/Cultural Studies* Vol. 4 Issue 2 (2007) fq. 142-165; Mari-Žanin Čalić, *Istorija Jugoslavije u XX veku*, fq. 340-341.

[70] Në literaturë është vërejtur se reformat kushtetuese në nivel federal gjatë viteve 1967-1971, të cilat në fund u kurorëzuan me autonominë e gjerë politiko – territoriale të **Kosovës** dhe **Vojvodinës,** në dëm të Serbisë, ishin rezultat i koncesioneve të diktatorit komunist **Tito** dhe luftës së tij të brendshme për të menagjuar republikat jugosllave, në veçanti **Serbinë**. Kjo e fundit, nga komunistët jugosllavë, në veçanti nga diktatori **Tito**, por edhe nga sllovenët e kroatët, është parë si një republikë me tendenca të theksuara hegjemoniste. Kjo përbënte një hendikep për serbët dhe **Serbinë,** në veçanti pas rënies së udhëheqësit komunist federal serb, **Aleksandar Rankoviq**, në vitin 1966, që në rrethanat e klimës së viteve 1967-1971 paraqiste favor për **Kosovën** dhe **Vojvodinën**. Këto koncesione ndaj **Kosovës** dhe **Vojvodinës** dhe këtë situatë jo të favorshme, serbët e përjetuan si frustrim. Cf. më shumë për këtë në Dejan Jović, *Yugoslavia: A State that Withered Away* (Purdue University Press: West Lafayette, Indiana, 2009) fq. 99-105; Ky frustrim serb do të manifestohet për herë të parë në formë të hapur përmes të a.q. **Libri i Kaltërt,** pak vite pas nxjerrjes së kushtetutave të vitit 1974 të të gjitha niveleve dhe, më pastaj, në mesin e viteve '80 të shekullit të kaluar përmes **Memorandumi të ASSHA**. Në fakt, shumë ide, përfundime, analiza dhe rekomandime të **Memorandumit** e kanë origjinën te **Libri i Kaltërt** i vitit 1977. Në këto dy dokumente sulmohej ashpër statusi i dy krahinave autonome, të cilat shiheshin si shkaku i krejt të keqes së Serbisë, flitej për diskriminimin e serbëve nga ana e shqiptarvëe, kroatëve dhe popujve tjerë, flitej për synimin e reintegrimit të serbëve në një shtet të vetëm dhe kështu me radhë. Fokusi primar i këtyre dy dokumenteve, megjithatë, ka qenë **Kosova** dhe shqiptarët dhe pozita e tyre e favorshme sipas Kushtetutës së vitit 1974, për të cilën e fajsonin diktatorin komunist **Tito** sepse, sipas serbëve, ai me qëllim kishte bërë koncesionet ndaj Kosovës për ta dëmtuar Serbinë dhe serbët. Cf. më shumë për raportin e brendshëm të forcave në mes të republikave dhe krahinave jugosllave, **Librin e Kaltërt** dhe lidhshmërinë e tij me **Memorandumin e ASSHA** në këto studime: Nebojša Popov (ed.), *The Road to War.Trauma and Catharsis* (CEU Press: Budapest, 2000) fq 29-31; Ana S. Trbovich, *A Legal Geography of Yugoslavia's Disintegration*, fq. 195- 204; Jasna Dragović-Soso, *"Saviours of the Nation": Serbia's Intellectual Opposition and the Revival of Nationalism* (C. Hurst & Co. Ltd.: London, 2002) fq. 177-193.

Edhe popujt tjerë, Memorandumi i cilësonte si përfitues në kurriz të serbëve, të cilët ishin ndarë, siç thuhej në te, nga kroati **Tito**, në tri pjesë (dy krahinat autonome dhe Serbia e sotme), me qëllim të shfrytëzimit të tyre nga të gjithë. Memorandumi fare nuk merrte parasysh situatën e brendshme dhe raportin e forcave që ishte krijuar me Kushtetutën e vitit 1974, ku **Kosova** paraqiste një akter serioz në lojën e pushtetit brenda **Jugosllavisë**. Edhe popujt tjerë kishin nevojë për votën dhe mbështetjen e **Kosovës** dhe e dinin fare mirë se, me eliminimin e saj nga loja federale për pushtet, radha e tyre nuk do të ishte shumë larg për të pasur fatin e njëjtë me te.

Një faktor tjetër që Memorandumi nuk e kishte pasur parasysh, ishte raporti ndërkombëtar i forcave në kohën kur synohej realizimi i tij nga **S. Millosheviq**: koha e **Luftës së Ftohtë** po merrte fund, siç po merrte fund roli udhëheqës i ish-**BRSS** dhe i rusëve, aleatëve kryesorë të Serbisë dje dhe sot, kurse **Evropa** po bashkohej në një platformë të re, krejtësisht liberale. Kjo ishte një situatë ndërkombëtare e kundërt me synimet e Memorandumit, i cili ishte përpiluar me shpresën se do të vihej në jetë në kohën kur ende rusët do të kenë primatin në marrëdhëniet ndërkombëtare.[71]

Njëjtë siç kishte bërë **Hitleri** me ardhjen në pushtet në vitit 1933, Memorandumi portretizonte serbët si viktima të të gjithë tjerëve, viktimizim që, sipas tekstit të tij, duhej dhe mund të ndërpritej vetëm përmes restaurimit të dinjitetit të nëpërkëmbur serb. Një gjë e tillë nënkuptonte se popujve të tjerë, në rend të parë kroatëve, boshnjakëve dhe shqiptarëve u duheshin zvogëluar të drejtat dhe liritë e fituara. Një gjë e tillë nuk mund të bëhej ndryshe pos me dhunë dhe luftëra të përgjakshme kundër gjithë popujve të tjerë jo serbë. Për t'u realizuar në praktikë, kjo politikë kërkonte një lider të marrë, një **fuhrer serb**, i cili u gjet në personin pafundësisht egocentrik të **S. Millosheviq**.

Në vazhdën e realizimi të këtyre qëllimeve memorandumiane duhen parë edhe ndryshimet kushtetuese në Kosovë dhe brutaliteti shtetëror i përdorur kundër shqiptarëve me rastin e miratimit të tyre nga **Kuvendi i Kosovës** më datën 23 mars 1989, si dhe dhuna që vazhdoi të përdorej kundër kroatëve dhe boshnjakëve viteve në vijim.

Me këto amendamente kushtetuese, të kryera me dhunë në rrethanat e gjendjes së jashtëzakonshme, **Kosova** dha pëlqimin e vet për ndryshimet kushtetuese me të cilat Serbisë i njihej e drejta për ta futur **Kosovën** nën dominimin e vet shtetëror në të gjitha fushat juridiko-politike, kushtetuese, socio – ekonomike, kulturore etj. Me dhënien e këtij pëlqimi nga ana e **Kosovës**, **Serbia** miratoi amendamentet kushtetuese, në veçanti amendamentin **XLVII** në **Kushtetutën e Republikës së Serbisë** të vitit 1974. Me këtë hap **Kosova** humbi të drejtën e vetos në ndryshimin e **Kushtetutës së Serbisë**, të cilën e kishte gëzuar në bazë të **Kushtetutës së RSFJ** të viti 1974, veto që përbënte një garancion për krahinat autonome kundër dominimit dhe hegjemonisë serbe. Me këtë pëlqim të dhënë, **Kosovës** iu hapën rrugët për reintegrim të dhunshëm në tërësi në sistemin juridik – kushtetuese, socio-politik, ekonomik, kulturor dhe tjetër të **Republikës së Serbisë**. Kjo u pa një vit më vonë kur u miratua **Kushtetuta e Serbisë** (shtator 1990): me këtë kushtetutë statusi i **Kosovës** u reduktua në status të një autonomie lokale, duke përjashtuar, tani e tutje, çdo ndikim të shqiptarëve në vendimmarrje lidhur me punët e **Kosovës.**[72]

Miratimi i amendamenteve të datës 23 mars të vitit 1989, pati për pasojë reagimin e shqiptarëve në gjysmën e parë të vitit 1990: më 2 korrik u shpall **Deklarata e Pavarësisë së Kosovës,** kurse më 7 shtator 1990 u miratua **Kushtetuta e Kaçanikut**. Përgjigja serbe qe shumë e ashpër: në qershor dhe korrik të vitit 1990, u nxorën dy ligje që i jepnin të drejtën **Republikës së Serbisë** për të vepruar në situatat e gjendjes së jashtëzakonshme në tërë territorin e saj, përfshirë **Kosovën**, me qëllim të sigurimit të ligjshmërisë, kushtetutshmërisë si dhe, siç thuhej atëbotë, respektimit të të drejtave dhe lirive njerëzore e të demokracisë. Përveç kësaj, këto ligje rrënuan tërësisht të gjitha institucionet kosovare të themeluara

---

71 Dimitar Bechev, *Rival Powr. Russia in Southeast Europe,* fq. 26-27, 30, 32,46 & 91-92; P. M. H. Bell & Mark Gilbert, *The World Since 1945: An International History.* 2nd Edition (Bloomsbury Academic: London etc., 2017), pjesa e pestë, "Part Five: The Ending of Cold War", ku autori flet gjerësisht për shkaqet dhe pasojat e përfundimit të **Luftë së Ftohtë**, rolin e presidentit sovjetik **Michail Gorbacov**, si dhe rrugën e ndjekur nga Serbia dhe ish-jugosllavët në fund të vitete '80 dhe fillim të viteve '90 të shekullit të kaluar).

72 Liljana Slavnić, *Ustavno pravo* (Privredna Akademija: Novi Sad, 2007) fq. 134- 135, 385-387.

në bazë të kushtetutave të vitit 1974, të **RSFJ** dhe **KSAK**. Me këto dy ligje bëhej përligjësimi i gjendjes së jashtëzakonshme në Kosovë, e cila kishte nisur në pranverë të vitit 1989 me qëllim të detyrimit të **Kosovës** që të jepte pëlqimin në amendamentet e sipërcekura kushtetuese me të cilat **Kosova** u zhvesh në tërësi nga çdo e drejtë autonome që e kishte gëzuar sipas kushtetutave të **RSFJ** dhe **KSAK** të vitit 1974. Këto dy ligje, me fjalë të tjera, nuk bënin asgjë tjetër pos që në tërësi abrogonin autonominë e vjetër të gëzuar nga kosovarët si dhe rrënimin total të institucioneve të themeluara në mënyrë autonome nga Kosova. Kjo bëhej në kushtet e një gjendje të jashtëzakonshme, pra në gjendje të jashtëzakonshme po abrogoheshin nga ana e Serbisë të gjitha institucionet kosovare të themeluara sipas kushtetutave të **RSFJ** dhe **KSAK** të vitit 1974.[73] Me këtë, në mënyrë formale-juridike, Kosova po futej në sundim të drejtpërdrejt nga Beogradi në stilin e regjimeve koloniale të instaluara në mënyrë brutale nga ana e shteteve metropole. Këtu bënte pjesë edhe abrogimi i **Gjykatës Kushtetuese të KSAK**, e themeluar në vitin 1972 në bazë të amendamenteve kushtetuese të një viti më herët.[74]

Në **Serbi**, këta hapa u cilësuan si një sukses i madh sepse, siç thuhej, **Serbia** më në fund u bë shtet normal dhe anëtar i barabartë i **RSFJ**-së.[75] Më këtë qasje, u mor vesh, nuk pajtoheshin asnjëra prej ish-republikave jugosllave (përveç **Malit të Zi**, satelitit të **Serbisë** së asaj kohe, kurse **Vojvodina** nuk kishte arritur fare të rezistojë si pasojë e raportit të brendshëm të forcave në favor të serbëve lokal). Amendamentimi i kushtetutave republikane në kundërshtim të hapur me **Kushtetutën e RSFJ të viti 1974** vazhdoj edhe më fort nëpër republikat tjera, si reagim ndaj politikave agresive të Serbisë (dhe Malit të Zi).

Para se të kalojmë në ish-republikat jugosllave dhe amendamentimet e tyre kushtetuese, të cilat, si një reagim në vetëmbrojtje ndaj politikave serbe, në mënyrë graduale çuan në rrënimin e tërësishëm të ish-Jugosllavisë, këtu i kthehemi kalimthi disa teksteve kushtetuese serbe që kanë pasur një efekt të drejtpërdrejt në Kosovë dhe historinë e saj kushtetuese dhe tjetër. E kemi fjalën për **Kushtetutën e RFJ** të vitit 27 prillit 1992, e njohur si **Kushtetuta e Zhablakut** (sipas qytezës në malet piktoreske të **Durmitorit** në veri të Malit të Zi), **Kartën Kushtetuese** të vitit 2003 dhe, së fundi, **Kushtetutën e Serbisë** të vitit 2006, pra të Serbisë si njërit prej shteteve të reja të dala nga rrënojat e ish-Jugosllavisë.

Kur u nxor **Kushtetuta e Serbisë** në shtator të vitit 1990, **Kosova** fare nuk figuronte si entitet me të drejtë të vetos apo ndonjë të drejtë tjetër që kishte gëzuar në të kaluarën sipas dy kushtetutave të vitit 1974, të **RSFJ**-së dhe **KSAK**: me amendamentet në Kushtetutën e RS të Serbisë të datës 28 mars 1989, amendamentet IX-XLIX, u ndryshua procedura për ndryshimin e **Kushtetutës së RSS**: tani e tutje më nuk kërkohej pëlqimi i **Kosovës** dhe **Vojvodinës**. Kjo u bë e mundur pasi që, më datën 23 mars 1989, autonomia e Kosovës, e garantuar sipas **Kushtetutës së RSFJ** të 1974 ishte ndryshuar me dhunë nga ana e **Serbisë**.[76] Ky ndryshim i pozitës kushtetuese në nivel të **RSFJ**, i kryer përmes rrënimit të autonomisë së **Kosovës** me datën 23 mars 1989, prishi balanset në nivel federal dhe shkaktoi reagim zinxhiror të republikave ish-jugosllave në veri të vendit dhe gjetiu.

Vitin në vijim, **Kosova** menjëherë shpall pavarësinë e vet më datën 2 korrik 1990, kurse më 7 shtator 1990 nxjerr **Kushtetutën e Kaçanikut**, për të cilën flasim në vijim më poshtë. Republika e Serbisë ende para nxjerrjes në shtator të vitit 1990 të kushtetutës së re, reagon ashpër ndaj këtyre hapave të kosovarëve dhe shkatërroi çdo institucion të mbetur të Kosovë (kuvendin, organin ekzekutiv, gjykatat e rregullta dhe **Gjykatën Kushtetuese të KSAK**, si dhe çdo institucion tjetër), duke çimentuar masat e gjendjes së jashtëzakonshme, të cilat, **de facto,** kanë zgjatur deri në çlirimin e Kosovës më 10 qershor 1999. Kjo

---

73 Ibid. fq. 386.

74 Për **Gjykatën Kushtetuese të KSAK**, deri në rrënimin e saj nga diktatori serb **Sllobodan Milosheviq**, cf. më shumë në Mirosal Cerar, "Slovenia's Constitutional Court Within the Separation of Power". Në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Përspective* (Kluwer Law International: The Hague, 2010) fq. 213-245, në f. 213, fusnota nr. 2; për zhvillimet kushtetuese në ish-Jugosllavi gjatë përiudhës komuniste, Cf. më shumë në Jovan Gjorgjeviq, *E drejta kushtetuese*, 75-114; Dimitrije Kulić, *Ustavno Sudstvo u Svetu*, fq. 157-190.

75 Liljana Slavnic, *Ustavno pravo,* fq. 385-386.

76 Kuvendi i **KSAK** në këtë ditë ka dhënë pëlqimin për ndryshimin e **Kushtetutës së RSS** me të cilin pëlqim autonomia e **Kosovës** dhe **Vojvodinës** në tërësi shuhet ashtu që më nga to nuk ka nevojë të kërkohet asnjë pëlqim për ndyrshime kushtetuese në **Serbi.**

nënkupton se **Kushtetuta e Republikës së Serbisë** e shtatorit të vitit 1990, edhe në aspektin formal, abrogon çdo element të autonomisë së Kosovës: tani e tutje, **Kosova** nuk ka asnjë kompetencë kushtetuese dhe ligjvënëse, duke u kthyer kësisoj në gjendjen e viteve 1945-1969, kur dominohej e administrohej **de facto** dhe **de jure** nga regjimi në **Beograd**. Në këtë fazë, nga shtatori i vitit 1990, as që mund të bëhet fjalë për ndonjë gjyqësi kushtetuese kosovare?

Me **Kushtetutën e Zhabljakut** të vitit 1992, nuk ndryshohet asgjë në statusin e **Kosovës**: vendi vazhdon të qeveriset në mënyrë të centralizuar dhe më dorë të hekurt nga regjimi serb i Beogradit i instaluar me dhunë në vend, një lloj sistemi i sundimit të guvernatorëve i kohës koloniale ku popullsia lokale shërben vetëm si objekt për të vepruar mbi te me tërë ashpërsinë dhe brutalitetin shtetëror. Në këtë periudhë shqiptarët në tërësi u përjashtuan nga puna dhe jeta publike, nisin një sistem paralel të jetës publike, të vetorganizimit politik mjaft civilizues sipas çdo kriteri civilizues dhe tjetër. Për këtë flasim, në vijim. Për gjyqësinë kushtetuese në kuadër të **RFJ** kemi folur në kapitujt pararendës, përfshirë këtu edhe gjyqësinë kushtetuese pas lidhjes së **Marrëveshjes së Beogradit** të 14 marsit 2002, me të cilën është ndërruar emri i **RFJ** në **USMZ**. Bazuar në këtë marrëveshje, më datën 4 shkurt 2003, është nxjerrë **Karta Kushtetuese** me të cilën u parashikua themelimi i organeve të përbashkëta të bashkësisë shtetërore dhe çdo aspekt tjetër i marrëdhënieve në mes të **Serbisë** dhe **Malit të Zi**. Si Marrëveshja ashtu dhe Karta sanksiononin një marrëdhënie krejtësisht konfederale në mes të këtyre dy republikave ish-jugosllave, diçka që kemi folur më herët në kapitullin e pestë.

T'i kthehemi tani amendamentimit kushtetues në nivel jugosllav në kundërshtim të hapur me **Kushtetutën e RSFJ** të vitit 1974, i cili ndodhi si reagim ndaj ndryshimeve të dhunshme kushtetuese që kishin ndodhur në **Kosovë** më datën 23 mars 1989. Kjo nisi me sllovenët. **Republika e Sllovenisë** në verë të vitit 1989, kishte nxjerrë amendamentet në **Kushtetutën e Sllovenisë** të vitit 1974, **amendamentet IX-XC**, të cilat po ashtu hapur ishin kundër formës dhe përmbajtjes së **Kushtetutës së RSFJ,** por, për dallim nga amendamentimet serbe, në një drejtim tjetër shumë civilizues dhe aspak hegjemonist.[77] Ndër këto amendamente bënin pjesë ato që kishin të bënin me tregun e përbashkët: sllovenët kërkonin që të kishin mbrojtje nga ngecjet në zhvillim teknologjik të pjesëve tjera të ish-Jugosllavisë që nuk ishin në gjendje të ndiqnin të arriturat tekniko-teknologjike të kohës, në veçanti në lëmin e teknologjisë informative dhe të komunikimit në përgjithësi. Kjo përbënte një aspekt të fuqishëm të vetëvendosjes ekonomike të këtij vendi kundër tendencave hegjemoniste të **Serbisë** për eksploatim ekonomik të popujve tjerë.

Një aspekt tjetër që ndërlidhet me këtë, pra me reagimin slloven ndaj hegjemonizmit serb dhe politikës së dhunshme ndaj **Kosovës**, ka të bëjë me dispozitat e amendamenteve si më sipër lidhur me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme dhe me procedurën e realizimit të së drejtës për vetëvendosje dhe caktimit të titullarëve të kësaj të drejte. Me amendamentet që kishin të bënin me gjendjen e jashtëzakonshme, si reagim ndaj ngjarjeve në **Kosovë** të datës 23 mars 1989, sllovenët kërkonin që gjendja e jashtëzakonshme të mos mund të shpallej asnjëherë pa pëlqimin e të gjitha njësive federale. Kjo arsyetohej me faktin se fjala ishte për territor jugosllav dhe për këtë kërkohej konsensusi i përbashkët i të gjitha republikave dhe krahinave autonome. Për këtë arsye, amendamentet kërkonin që përfaqësuesit sllovenë në federatë të bojkotonin çdo shpallje të gjendjes së jashtëzakonshme në territorin slloven nga ana e federatës kur kjo bëhej pa pëlqimin e tyre. Sllovenia, ndërkaq, ruante të drejtën për të tërhequr përfaqësuesit e vet në federatë në rast se kjo gjendje imponohej për territorin slloven.

I fundit dhe më i rëndësishmi amendament në kuadër të amendamenteve si më sipër kishte të bënte me te drejtën për vetëvendosje të **Sllovenisë**: me paragrafin e tretë të pikës së parë të amendamentit **LXVIII** parashikohej e drejta e këtij vendi për të rregulluar në mënyrë të pavarur çështjet që kanë të bëjnë me aspektet materiale dhe procedurale të realizimit të së drejtës për vetëvendosje.[78] Ky amendament vinte si reagim ndaj

---

77 Për tekstin e amendamenteve, cf. "Amandmani na Ustav SR Slovenije" (shtojcë e veçantë), gazeta **BORBA** (Beograd) 7 gusht 1989.

78 Cf. për tekstin e vendimit të **Gjykatës Kushtetuese të RSFJ** në Milovan Buzadzić, *Secesija bivsih jugoslovenskih republika u svetlosti odluka Ustavnog dusa Jugoslavije* (Sluzbeni list SRJ: Beograd, 1994) (në gjuhën serbe me alphabet cirilik) fq. 72-74. Për komentet e redaktuesit të kësaj përmbledhje, cf. ibid. fq. 23-30; Komentet e këtij autori, si krytar i fundit i kësaj gjykate, përfaqësojnë pa asnjë rezrvë qasjen serbe sipas së cilës e drejta për vetëvendosje mund të realizohej vetëm në nivel të ish-**RSFJ** përmes nxjerrjes së një ligji federal dhe assesi në mënyrë parciale në nivel republikan).

politikave serbe të reintegrimit të dhunshëm të **Kosovës**, si dhe i synimit serb që me çdo kusht të rregullohej realizimin e kësaj të drejte në nivel federal, pra në nivel të krejt **Jugosllavisë.** Ky insistim serb për realizim të kontrolluar të së drejtës për vetëvendosje të popujve jo serbë vinte si pasojë e faktit se në këtë kohë serbët e kishin futur nën kontroll të tërësishëm strukturat shtetërore federale të ish-**Jugosllavisë**. Një insistim i tillë bëhej për disa arsye, të cilat i japim në vijim:

- e para, kjo bëhej sepse diktatori serb, **S. Millosheviq,** kishte marrë për detyrë realizimin e Memorandumit, me të cilin synohej krijimi i **Serbisë së Madhe** përmes largimit të sllovenëve me shpresë se me popujt tjerë më lehtë do të arrihej larja e llogarive reciproke;
- e dyta, sepse serbët, d
- uke qenë në kontroll të strukturave federale e dinin se së shpejti ai shtet do të shpërbëhej dhe shikonin që të përfitonin sa më shumë territor dhe pasuri në dëm të popujve tjerë jo serbë;
- *e treta*, sepse shtrirja e serbëve ishte nëpër të gjitha njësitë federale të ish-Jugosllavisë të cilat Memorandumi i kishte vënë në shënjestër të territoreve me rëndësi strategjike për realizmin e projektit të **Serbisë së Madhe**; dhe, së fundi,
- *e katërta*, sepse serbët nuk ishin fare të vetëdijshëm se në planin global ndërkombëtar në këtë kohë kishte ndodhur një ndryshim strategjik i përmasave tektonike ashtu që tani, tutori i tyre, **Rusia**, kishte humbur çdo ndikim në rendin e ri që ishte në ndërtim e sipër pas kolapsit të komunizmit dhe nisjes së procesit të shpërbërjes së ish-**BRSS**-së dhe federatave të tjera komuniste (**Jugosllavia** dhe Çekosllovakia).

Ky amendament slloven u shpall si antikushtetues me një vendim të **Gjykatës Kushtetuese të RSFJ**, pra, amendamenti me të cilin sllovenët rregullonin aspektet materiale e procedurale të realizimit të së drejtës për vetëvendosje. Vendimi u mor në janar të vitit 1990. Krahas këtij amendamenti, si anti-kushtetues u shpallën pjesa dërrmuese e amendamenteve të tjera si më sipër të nxjerra nga sovrani slloven. Më i rëndësishmi ndër to ishte ai që bënte fjalë për vetëvendosjen dhe ka shumë rëndësi që këtu ta diskutojmë në vijim më gjerësisht esencën e vendimit të Gjykatës. Ta shohim, pra, në vijim se cili ka qenë **raison d'etre** i vendimit më të cilin u shpall si anti-kushtetues amendamenti slloven për aspektet materiale dhe procedurale të realizimit të së drejtë për vetëvendosje.

Në fillim, Gjykata konstatonte se republikat jugosllave dhe popujt e tyre kishin të drejtën për vetëvendosje deri në shkëputje sepse, sipas saj, kjo ishte pjesë e parimeve dhe e vetë natyrës së **RSFJ**. Kjo natyrë buronte nga fakti se bashkimi i popujve jugosllavë ishte kryer mbi baza krejtësisht vullnetare dhe, për pasojë, mbi po këtë bazë edhe mund të vinte deri te prishja e bashkimit fillestar në mes të këtyre popujve dhe republikave të tyre. Kjo nënkuptonte, gjithnjë sipas interpretimit të Gjykatës, se këta popuj dhe republikat e tyre kishin bartur me vullnetin e tyre sovran në nivel federal realizmin e disa interesave që ishin të përbashkëta për të gjithë. Një bashkim i tillë vullnetar nënkuptonte të drejtën dhe detyrimin e të gjithëve për të mbrojtur me çdo kusht dhe në çdo rrethanë integritetin territorial të **RSFJ**-së. Kjo e drejtë dhe kjo detyrë i takonte të gjitha republikave dhe krahinave autonome. Ndryshimi territorial, për pasojë, mund të vinte vetëm si rrjedhojë normale e pajtimit të të gjithëve dhe assesi në mënyrë të njëanshme dhe pa marrëveshje të sërishme në mes të gjithë atyre që kishin krijuar atë shtet. Thënë me fjalë tjera, sipas vendimit përfundimtar të Gjykatës, e drejta për vetëvendosje ishte një e drejtë federale dhe assesi një e drejtë republikane ashtu që, për pasojë, realizimi i saj nuk mund të rregullohej në nivel republikan por vetëm në atë federal. Një konstatim i tillë, më tutje, nënkuptonte se subjektet dhe objekti i të drejtës për vetëvendosje, si dhe procedura (mënyra) e vënies së saj në jetë duheshin rregulluar me një ligj federal dhe assesi me ndonjë ligj republikan (lëre më me ligj krahinor, sepse krahinat as që merreshin seriozisht si titullarë të vetëvendosjes, duke u cilësuar ekskluzivisht si njësi vetëqeverisëse të pakicave kombëtare të **RSFJ**).

Ky amendament, siç u tha më sipër, së bashku me shumicën dërrmuese të amendamenteve sllovene ishin shpallur si antikushtetuese me vendimin e janarit të vitit 1990. Kjo u bë si pasojë e faktit se nga viti 1990 e tutje Gjykata dominohej thuajse në tërësi nga serbët, të cilët kishin nisur të merrnin nën kontroll një nga një të gjitha institucionet federale të ish-Jugosllavisë, derisa ndodhi shpërbërja e saj totale më 27 prill 1992. **Kjo politikë serbe, në të njëjtën kohë, i shpallte të tjerët që fitonin pavarësinë si pasojë**

e dhunës serbe si secesionistë, kurse veten e shpallte si ruajtës dhe trashëgimtar të vetëm juridik dhe legjitim të Jugosllavisë, si në planin ndërkombëtare ashtu dhe në aspektin kushtetues. Në fakt, në kohën e dhënies së mendimit për kushtetutshmërinë e këtyre amendamenteve sllovene, Gjykata në tërësi ka qenë nën kontrollin politik serb sepse të gjithë përfaqësuesit jo serbë kishin ikur në shenjë proteste kundër politikave hegjemoniste serbe ndaj tjerëve. Në këtë kohë, me **Serbinë** kishin ngelur vetëm malazezët dhe përfaqësuesit nga **Kosova** e **Vojvodina**, të cilave **Serbia** ua kishte hequr çdo autonomi në vendimmarrje.[79]

Qasja serbe që sot e kësaj dite insiston në kontinuitetin shtetëror juridiko-ndërkombëtar dhe kushtetues me ish-Jugosllavinë bazohet në disa premisa. Kjo e fundit, premisa lidhur me kontinuitetin kushtetues, bazohet në premisën që lidhet me mënyrën e formimit të **RFJ** më datën 27 prill 1992: serbët besonin se respektimi i formës, me kuptim respektimi formal i **Kushtetutën e RSFJ** të vitit 1974 gjatë krijimit të RFJ, mjaftonte që t'i bënte ata trashëgimtar të vetëm kushtetues të ish-RSFJ. Kjo rrethanë, gjithnjë sipas serbëve, ka mjaftuar që tjerët të shpallen si secesionistë pa asnjë të drejtë lidhur me të drejtat dhe asetet e shtetit pararendës.

Premisat tjera lidhur kontinuitetin shtetëror të Serbisë me ish Jugosllavinë, sipas serbëve, konsistojnë në sa vijon:

- e para, serbët që nga fillimi i jetës së ish **Jugosllavinë** më 1 dhjetor 1918 e deri në shpërbërjen e saj më 27 prill 1992, kanë qenë komb konstitutiv (themelues) i atij shteti;
- e dyta, e drejta për vetëvendosje ka mund t'u takoi vetëm popujve konstitutivë (themelues) të ish-**Jugosllavisë**, të cilët, pas federalizmit të saj më 1945, kanë qenë si vijon: serbët, kroatët, sllovenët, maqedonasit, malazezët dhe, pas mesit të viteve '70 të shekullit të kaluar, edhe boshnjakët myslimanë;
- e treta, secesioni si forma kryesore dhe më sublime e realizimit të së drejtës për vetëvendosje nuk i ka takuar republikave (lëre më krahinave autonome që cilësoheshin se entitete të pakicave kombëtare), por vetëm kombeve konstitutive (themeluese); për pasojë, ata që iknin nga ish-**Jugosllavia,** duheshin trajtuar si secesionistë, kurse ata që donin të rrinë në të, si titullarë që gëzojnë të drejtën për vazhdim të kontinuitetit shtetëror juridiko - ndërkombëtar të shtetit pararendës, ish- **Jugosllavisë**;
- e katërta, serbët fare nuk e kishin parasysh se edhe republikat tjera që po pavarësoheshin nga ish-Jugosllavia, kishin nxjerrë dokumentet e tyre kushtetuese, pikërisht duke u bazuar formalisht në **Kushtetutën e RSFJ** të vitit 1974;
- e pesta, e drejta për të gëzuar statusin e shtetit që ka kontinuitet shtetëror juridik- ndërkombëtar dhe juridik-kushtetues me shtetin pararendës, në këtë rast me ish- Jugosllavinë (1918-1992), buronte nga dy fakte historike themelore: faktit se dy shtetet pararendëse të cilat kishin themeluar ish-**Jugosllavinë**, **Mbretëria e Serbisë** (1882-1918) dhe **Mbretëria e Malit të Zi** (1910-1918), gjithnjë sipas serbëve, përbënin shumicën e territorit dhe të popullsisë konstitutive (themeluese) të shtetit pararendës, pra të ish-**Jugosllavisë**, dhe, faktit tjetër, se ish-**Jugosllavia** kishte qenë anëtare e OKB-së, bile anëtare me të drejtat e njërit prej themeluesit të saj në **San Francisko** në vitin 1945;
- e gjashta, anëtarësimi në **OKB** i ish-Jugosllavisë paraqet një të drejtë absolute për t'i cilësuar tjerët si secesionistë, pa asnjë të drejtë të tyre për të trashëguar atë si shtet pararendës. Këtë qasje serbët e argumentojnë, dje dhe sot, me të drejtën e **Indisë** që kishte trashëguar të drejtën e anëtarësimit në **OKB** me rastin e shkëputjes nga ajo të **Pakistanit** dhe **Bangladeshi**t. Kjo analogji me **Indinë**, megjithatë, nuk qëndron aspak në pikat themelore: pavarësimi i shteteve që

[79] Për këndvështrimin serb të këtyre vendimeve të natyrës krejt politike të **Gjykatës Kushtetuese të RSFJ**, Cf. komenetet e kryetarit të fundit të asaj gjykate, serbit **Milovan Buzadzic**, në Milovan Buzadzić, *Secesija bivsih jugoslovenskih republika u svetlosti odluka Ustavnog dusa Jugoslavije*, fq. 57-65 (pikëpamjet e tij janë shprehur në fjalimin e tij para Kuvendit të RSFJ, në cilësinë e tij formale si kryetar i **Gjykatës Kushtetuese të RSFJ**, me të cilin raportonte për gjendjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në nivel jugosllav, gjendje të cilën e cilësonte si dramatike dhe në tërësi e orientuar kah rrënimi i tërësishëm i rendit juridik-kushtetues dhe lufta civile).

dikur përbënin atë që njihej si **India Britanike** (**Pakistani, Bangladeshi** dhe **India** e sotme) ka ndodhur në kontekstin kolonial, jo në kontestin e shpërbërjes së një shteti të pavarur dhe sovran, siç është shpërbërja e ish-**Jugosllavisë**. Jo vetëm procesi i dekolonizimit e bën të ndryshëm esencialisht rastin e Indisë me ish-**Jugosllavinë**: me rastin e shpërbërjes së **Indisë Britanike** ka eksituar një marrëveshje e tri shteteve të reja si më sipër për t'ia pranuar vetëm njërit prej tyre, **Indisë**, kontinuitetin shtetëror me shtetin pararendës, **Indinë**, siç kishte ndodhur edhe në disa raste tjera përgjatë historisë kur iu është njohur nga ana e bashkësisë ndërkombëtare kontinuiteti shtetëror vetëm njërit prej shteteve të reja të dala nga shpërbërja e shtetit pararendës. Të tilla raste kanë qenë **Austria, Turqia** dhe ish-**BRSS** pas **Luftës së Parë Botërore**, të cilave iu njoh statusi i vazhdimësisë me shtetin pararendës, përkatësisht me **Austro - Hungarinë**, **Perandorinë Otomane** dhe **Rusinë Cariste**. Kjo ka ndodhur edhe pas mbarimit të Luftës së Ftohtë kur **Federatës së Rusisë** iu njoh e drejta për vazhdimësi shtetërore me ish BRSS. Krejt këto raste, thënë ndryshe, kanë ndodhur sepse ka ekzistuar një konsensus në bashkësinë ndërkombëtare sa i përket fizionomisë së shteteve të reja të krijuara nga një shtet pararendës, tanimë i shpërbërë (**Perandoria Austro – Hungareze, Perandoia Otomane, Rusia Cariste** dhe ish **BRSS**).[80]

U mor vesh, këtë qasje serbe mbi kontinuitetin shtetëror juridiko – ndërkombëtar dhe juridiko – kushtetues që u diktua deri këtu, nuk e ka pranuar askush nga bashkësia ndërkombëtare dhe asnjëri nga ish shtetet e reja të krijuara nga rrënojat e ish **Jugosllavisë**.

Gjykata Kushtetuese e KSAK, e themeluar në vitin 1972, ka qenë dhe është e ndryshme nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: funksioni i saj primar ishte ruajtja dhe kultivimi i vlerave të sistemit diktatorial komunist në Kosovë, si pjesë e sistemit komunist në ish-Jugosllavi, sistem që bazohej në unitetin e pushtetit të klasës punëtore. Ky pushtet, sipas kushtetutave të vitit 1974, jugosllave dhe kosovare, ushtrohej nga lidershipi komunist dhe në emër të klasës punëtore: partia komuniste, e njohur si **LKJ**, si parti e vetme në pushtet me rol prijës (avangardë) të garantuar me kushtetutë (jugosllave dhe kosovare). Përveç këtij dallimi themelore konceptual, ajo gjykatë ka pasur edhe dallime të tjera që kanë të bëjnë me juridiksionin dhe vetë mënyrën e saj të funksionimit.

Sa i përket juridiksionit, siç u pa më heret, në juridiksion të vetin ajo ka pasur edhe mbrojtjen e ligjshmërisë, në ndërkohë që fare nuk e ka njohur institutin e **ankesës kushtetuese**. Si mekanizëm, ajo ka mund të vihet vetë në lëvizje, **sua sponte**. Jo vetëm kaq! Si një mekanizëm i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, ajo ka pasur edhe detyrën e policimit të fenomeneve që kanë të bëjnë me kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë, përkatësisht të mbikëqyrë lëvizjet dhe zhvillimet në sferën e kushtetutshmërisë e të ligjshmërisë dhe t'i raportojë të njëjtat në kuvendin krahinor, në mënyrë të njëjtë siç kishin detyrë ta bënin të gjitha gjykatat kushtetuese në territorin ish-jugosllav për territoret e tyre juridiksionale.

Sikundër u vërejt më sipër, **Gjykata Kushtetuese e KSAK** ka pasur dhe kompetenca të tjera që nuk janë aspak në natyrën e gjyqësisë kushtetuese që modelohet sipas sistemit të konstitucionalizmit perëndimor. Kjo, në fakt, në tërësi përputhet me natyrën dhe funksionin e kushtetutës dhe ligjit në një sistem komunist që bazohet në sistemin e kuvendeve dhe unitetit të pushtetit me partinë komuniste si avangardë e klasës punëtore dhe zbatuese e diktaturës së kësaj klase.[81] Dija dhe përvoja kushtetuese, e prodhuar nga kjo gjykatë kushtetuese në kohën e ish-**Jugosllavisë**, në asnjë mënyrë nuk ka mundur të shërbejë si pikë referimi për të gjykuar mbi vendimmarrjen e **GJKRKS**, si dhe për cilësinë e saj. Për fat të keq, megjithatë, ka ndodhur që shpeshherë analiza e "vendimeve të mëdha" të saj është bërë pikërisht

[80] Ibid., fq. 275-281 (ky autor, në cilësinë e ish krytarit të fundit të **Gjykatës Kushtetuese të RSFJ**, komenton vendimet e kësaj gjykate lidhur me çështjen e kontinuitetit shtetëror juridiko – ndërkombëtar dhe juridiko – kushtetues të ish Jugosllavisë; mendimi i tij përfaëson standardin serb të arsyetimit të këtyre aspekteve të shpërbërjes së ish Jugosllavisë; se kjo është kështu qartë shihet nga arsyetimi i këtyre vendimeve të **Gjykatës Kushtetuese të RSFJ**, të cilat shoqërohen me komentet e autorit në fjalë, vendime me të cilat anuloheshin një nga një si anti-kushtetuese vendimet e republikave dhe të **KSA të Kosovës** mbi shpalljen dhe vënien në jetë të pavarësisë së bashku me ligjet dhe aktet tjera implementuese të pavarësisë së shpallur nga to gjatë viteve 1990-1991).

[81] Për natyrën e pushtetit dhe për rolin e të drejtës në sistemin komunist të vendeve të ish-bllokut socialist, Cf. më shumë në Paolo Carroza, "Il diritto socialista", fq. 583-615; Karl J. Fridrih, *Kosntitucionalna Demokratija*, fq. 47-50.

nga kuadrot kosovare të kohës së komunizmit gjë që ka shkaktuar konfuzion në publik: analizat në fjalë janë bazuar në tërësi në parametrat e gjyqësisë kushtetuese të kohë së ish-Jugosllavisë. Kjo vlen, në veçanti, për analizat e tilla të bëra gjatë kohës sa ka qenë kryetar i saj autori i parë i këtij libri (2009-2015): analizat e vendimeve të **GJKRKS** që bëheshin nga "ekspertë kushtetues", në thelb ishin analiza që merrnin për bazë gjyqësinë kushtetuese të kohës së komunizmit. Një shprehje emblematike që vërteton këtë, është se këta "ekspertë kushtetues", pa qenë të bindur se po shpërfaqnin padije themelore, kontestonin juridiksionin e **GJKRKS** për të marrë aktgjykime: si është e mundur, thoshin këta ekspertë, që një gjykatë kushtetuese të marrë aktgjykime (sic!). Kjo logjikë flet mjaft, pa pasur nevojë të analizohen dijet e tyre në sferat tjera të juridiksionit që ka sot gjyqësia kushtetuese në Kosovë.

Gjykata Kushtetuese e KSAK ka ekzistuar në mënyrë efektive deri më 23 mars 1989. Në këtë datë, diktatori serb **S. Millosheviq** e rrënoi si të tillë, së bashku me autonominë që Kosova kishte gëzuar sipas Kushtetutës së vitit 1974.[82] Në aspektin formal, ajo ka vazhduar edhe pak muaj deri vitin në vijim kur formalisht, në fund të verës së vitit 1990, u suprimuan të gjitha organet e **KSAK,** proces që u kurorëzua me xjerrjen e **Kushtetutës së Serbisë** (shtator 1990). Në këtë kohë, nga marsi 1989 deri në fund të verës së vitit 1990, **Serbia** në mënyrë graduale e vuri **Kosovën** në tërësi nën thundrën e sistemit të saj juridik-kushtetues, duke rrënuar të gjitha shënjat e identitetit kushtetues që vendi kishte gëzuar me vite sipas kushtetutave të vitit 1974 (të RSFJ dhe KSAK).[83] Kjo politikë prodhoi rezistencë masive në mesin e popullsisë shumicë në **Kosovë**, e cila deri në fillim të vitit 1998 pat qenë krejtësisht paqësore nën udhëheqjen e liderit të **Lidhjes Demokratike të Kosovës** (LDK) dhe presidentit të parë të **Kosovës**, **Dr. Ibrahim Rugova (1944-2006).** Gjatë kësaj kohe, kosovarët organizuan jetë paralele në sferën politike, sociale, arsimore, shëndetësore dhe ekonomike. Ky organizim paralel kishte për qëllim refuzimin e tërësishëm të integrimit të **Kosovës** në **Serbi**. **Kosova** dhe populli i saj shumicë **de facto** u përjashtuan nga çdo aspekt i jetës publike. Ata arritën, megjithatë, që t'i krijojnë vetes një lloj hapësire të jetës paralele publike, e cila jetë për serbët cilësohej si e huaj, por që me shumë sukses bashkekzistonte me hapësirën publike të imponuar me dhunë nga regjimi serb në **Kosovë**. Hapësira e imponuar serbe, për fat të keq, gjeti një përkrahje të madhe në mesin e popullsisë lokale serbe në **Kosovë**. Kjo situatë zgjati deri në fillim të vitit 1998, kur filloi një kryengritje e armatosur kundër regjimit të instaluar të Beogradit nën udhëheqjen e **UÇK**. Para se të flasim për paraqitjen e **UÇK**-së dhe shkaqet e saj, t'i kthemi pak produktit më emblematik të kohë së jetës publike paralele në **Kosovë**, të organizuar nga **LDK** e Dr. **Ibrahim Rugovës** dhe qeveria e tij në mërgim e udhëhequr nga Dr. **Bujar Bukoshi**. Fjalën e kemi për **Kushtetutën e Kaçanikut.**

Kushtetuta e Kaçanikut është miratuar nga përbërja e legjislaturës së fundit të **Kuvendit të KSAK**. Në këtë përbërje kanë marrë pjesë vetëm shqiptarët dhe disa prej deputetëve të komuniteteve joserbe dhe joshqiptare të **Kosovës**. Kuvendi ka vepruar në ilegalitet si pasojë e represionit serb dhe është mbledhur në **Kaçanik** të Kosovës për të miratuar këtë kushtetutë. Kjo ka ndodhur më datën 7 shtator 1990, në paralel me hapat e ngjashëm që i ndërmerrnin republikat ish-jugosllave dhe popujt e tyre në vijim të rezistimit të hegjemonisë serbe.

---

82 Miroslav Cerar, "Slovenia's Constitutional Court Within the Separation of Powers." Në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West*, fq. 213 fusnota nr.2.

83 Sipas **Kushtetutës së Serbisë** (shtator 1990), autonomia e Kosovës të cilën e gëzonte sipas Kushtetutës së RSFJ të vitit 1974, u suprimua dhe nuk ekzistonte më. Nenet 108-112 ["Krahina Autonome e Vojvodinës dhe Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë"] të Kushtetutës përcaktonin elementet bazë të "autonomisë së re" për Kosovën, kurse neni 6 ["Dispozitat Themelore"] emërtonte **Kosovën** si një krahinë autonome, krahas **Vojvodinës**, që gëzon një lloj autonomie lokale, pa asnjë premsië të autonomisë së dikurshme politiko - territoriale.

Kushtetuta e Zhabljakut (sipas emrit të vendit në Mal të Zi, ku është draftuar) ka sanksionunar këtë pozitë të **Kosovës** dhe **Vojvodinës,** duke respektuar në tërësi dispozitat e **Kushtetutës së Serbisë** të vitit 1990. Në kapitullin II, kjo Kushtetutë ka pasur dispozitat mbi të drejtat e njeriut, kapitull që titullohej: "Liritë, të Drejtat dhe Detyrat e Individit dhe Qytetarit" (nenet 19 – 68). Edhe pse në paragrafin 4 të nenit 124, Kushtetuta fliste për ankesën individuale në rastet e cenimeve me aktet individuale të autoriteteve publike të të drejtave dhe lirive të individit të garantuara me Kushtetutë, ushtrimi praktik i ankesës individuale në territorin e Kosovës nuk kishte asnjë gjasë dhe mundësi. **Kosova** dhe populli i saj ishin futur në një geto kolektive në duart e regjimit represiv të diktatorit serb **S. Milosheviq**.

Teksti i Kushtetutës është bërë nga duart e juristëve dhe intelektualëve më të shquar të Kosovës së asaj kohe[84], siç ishte bërë edhe **Deklarata Kushtetuese** (2 korrik 1990) nga dora akademikut **Gazmend Zajmi** (1936-1995).[85] Për shkak të rrethanave të vështira, historikisht të papërsëritshme, teksti i Kushtetutës nuk i është nënshtruar diskutimit publik, përkatësisht si pasojë e rrethanave të vështira të represionit policor dhe ushtarak serb. Në aspektin formal, ajo miratuar në vijim të respektimit të dispozitave të **Kushtetutës së KSAK** të vitit 1974. Ka pasur gjithsej njëqind e dyzetë (140) nene.

Në kuadër të pjesës së VII ["Organet Republikane"] të Kushtetutës, kapitulli i 6-të i kushtohej Gjykatës Kushtetuese: nenet 128-134 normonin juridiksionin dhe palët e autorizuara, zgjedhjen e gjyqtarëve e të kryetarit dhe imunitetin e tyre, disiplinimin e gjyqtarëve dhe kushtet për shkarkimin e tyre, mënyrën e vendimmarrjes dhe efektin juridik të vendimeve dhe, në fund, autonominë e rregullimit të saj të brendshëm.

Juridiksioni ishte shumë i ngjashëm me juridiksionin e gjykatave kushtetuese të disa prej republikave ish-jugosllave të kohës, në veçanti me **Gjykatën Kushtetuese të Kroacisë**. Në nenin 128 të Kushtetutës thuhej se Gjykata Kushtetuese:

- vendos mbi pajtueshmërinë e ligjeve, dispozitave e akteve të tjera dhe statuteve të komunave e të qytetit me Kushtetutën;
- vendos mbi pajtueshmërinë e dispozitave dhe të akteve të tjera të organeve republikane me ligjin;
- vendos mbi pajtueshmërinë e të gjitha dispozitave dhe akteve të tjera me ligjin dhe dispozitën tjetër republikane;
- vendos mbi pajtueshmërinë e statutit ose të aktit tjetër të partive politike, të lëvizjeve, të lidhjeve dhe të shoqatave me Kushtetutën përkatësisht mbi kundërshtinë me ligj;
- vendos mbi ndalimin e punës së partive politike, të lëvizjeve, të lidhjeve dhe të shoqatave;
- vendos mbi përgjegjësinë e kryetarit dhe të anëtarëve të Kryesisë së Republikës për shkelje të Kushtetutës;
- zgjedh çështjet kontestuese të zgjedhjeve në qoftë se nuk janë në kompetencë të gjyqeve dhe të organeve tjera shtetërore;
- kryen edhe punë të tjera që i janë lënë në kompetencë me Kushtetutë.

Çështja e palëve të autorizuara për të vënë në lëvizje këtë gjykatë rregullohej me nenin 131. Sipas tij, tri palë të autorizuara mund të paraqiteshin pranë Gjykatës: secili individ, organet shtetërore dhe, në fund, vetë Gjykata **sua sponte.**

Sikundër mund të vërehet nga kjo si më sipër, gjyqësia kushtetuese kosovare sipas **Kushtetutës së Kaçanikut** ka ruajtur disa prej premisave të gjyqësisë së mëhershme, njëjtë siç kishin bërë edhe republikat ish- jugosllave në atë kohë. Në rend të parë, Gjykata kishte në juridiksion të saj vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Në rend të dytë, në kuadër të juridiksionit të saj binte edhe kontrolli i kushtetutshmërisë së partive politike dhe shoqatave të qytetarëve sepse në këtë kohë ekzistonte frika se partitë politike dhe shoqatat e qytetarëve mund të futeshin në veprimtari të dhunshme anitkushtetuese dhe antiligjore si pasojë e mungesës së përvojës në pluralizmin politik dhe respektimin e lirive dhe të drejtave njerëzore. Në fund, si palë të autorizuara paraqiten të gjithë individët dhe secili organ shtetëror. Nëse këta nuk ngrehnin çështjen e vlerësimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, atëherë vetë Gjykata **sua sponte** mund të vihej në lëvizje. Kjo ka qenë një kompetencë e trashëguar nga përvoja e kaluara ish-jugosllave.

Sikundër shihet, gjyqësia kushtetuese sipas **Kushtetutës së Kaçanikut** nuk ka parashikuar **ankesën kushtetuese**, përkatësisht nuk ka parashikuar vënien në jetë të dispozitave të kapitullit III ["Liritë, të

[84] Grupi punues që ka punuar në draftin e Kushtetutës së Kacanikut është përbërë nga: prof. dr. **Kurtesh Salihu**, prof. dr. **Ejup Statovci**, prof. dr. **Ismet Salihu**, prof. mr. **Fatmir Fehmiu** dhe **Halit Muharremi**. Cf. Skender Skenderi (ed.), *Si veproi Kuvendi i Republikës së Kosovës. Vëllimi I (4.12.1989 – 7.09.1990)* (Printing presss: Prishtinë, 2016), fq. 401-402.

[85] Ibid., fq 330-331.

Drejtat dhe Detyrat e Njeriut dhe të Qytetarit"] të Kushtetutës. Neni i fundit, neni 79 i këtij kapitulli ka bërë fjalë për realizimin gjyqësor të të drejtave dhe lirive njerëzore, duke mos nënkuptuar me këtë gjyqësinë kushtetuese.

Në nenin si më sipër 79 gjendej dispozita kushtetuese që sanksiononte një tjetër qasje lidhur me statusin e lirive dhe të drejtave njerëzore: aty thuhej se ato nuk mund të merreshin dhe as të kufizoheshin nga askush, ndërsa me ligj mund të përcaktoheshin vetëm mënyrat e realizimit të tyre. Hapur shihet se kjo dispozitë është futur me qëllim të largimit nga trashëgimia komuniste ku liritë dhe të drejtat kushtetuese mund të kufizoheshin dhe të merreshin në çdo kohë me një ligj të zakonshëm. Edhe sa i përket detyrave kushtetuese, **Kushtetuta e Kaçanikut** përbënte një risi sepse ato detyra duheshin përmbushur ekskluzivisht në bazë të dispozitave kushtetuese dhe jo të atyre ligjore apo në bazë të tekeve të politikës ditore, siç kishte ndodhur në kohën e sistemit komunist jugosllav.

Edhe ky kapitull është i ndikuar nga dispozitat e ngjashme të kushtetutave demokratike të republikave ish-jugosllave, ku bëhej një lloj balansimi në mes të drejtave dhe detyrimeve dhe ku synohej realizimi sa më i gjerë i lirive dhe të drejtave kushtetuese, por duke mos parashikuar **ankesën kushtetuese** si mjet dhe si një mekanizëm për vënien në jetë të dispozitave të tilla. Kushtetutat e republikave ish-jugosllave shumë më vonë kanë parashikuar ankesën kushtetuese si mjet dhe një mekanizëm për vënien në jetë të dispozitave kushtetuese lidhur me liritë dhe të drejtat njerëzore.

T'i kthehemi tani çështjes ku ngelëm lidhur me paraqitjen e **UÇK**-së dhe rrethanat e kësaj paraqitjeje.

Paraqitja e **UÇK**-së në skenën publike kosovare ka qenë rezultat imediat i ngritjes dramatike dhe të shpejtë të dhunës dhe represionit serb në Kosovë si dhe i dështimit të rrugës paqësore të presidentit Dr. **Ibrahim Rugova** dhe **LDK**-së. **Kosova** në këtë kohë qe përjashtuar nga çdo proces paqësor që kishte filluar në kontekstin e zgjidhjes së krizës dhe luftës në ish - **Jugosllavi**, siç janë rastet e përjashtimit nga dy konferencat e paqes të mbajtura në **Hagë** (1991-1992) dhe në **Londër** (1992-1995). Arritja e paqes në **Bosnje-Hercegovinë** paraqiti kulmin e pakënaqësisë së kosovarëve me rrugën paqësore: pas arritjes së **Marrëveshjes së Dejtonit** në nëntor të vitit 1995, me të cilën iu dha fund luftës dhe konflikteve në Bosnje-Hercegovinë, u duk sikur vetëm dhuna dhe lufta e armatosur po shpërblehej nga perëndimorët. Përjashtimi i **Kosovës**, me kërkesën shprehimore të diplomacisë amerikane, me sa duket shpërfaqi, në të njëjtën kohë, dy gjëra të rëndësishme:

- e para, ngritjen e represionit dhe dhunës në Kosovë për shkak se lideri serb, **S. Millosheviq**, pas **Marrëveshjes së Dejtonit** u pa si një njeri i paqes në **Ballkan** dhe si garantues i Dejtonit që besonte se perëndimi do ta toleronte pafundësisht pasi kishte marrë këtë rol të garantuesit të paqes; dhe,
- e dyta, ngritjen e frustrimit në mes të popullsisë shumicë në **Kosovë** për shpërblim të **Serbisë së Millosheviqit** në **Dejton**, përkundër luftërave të saj agresive dhe gjenocidale në territorin ish-jugosllav (**Bosnje – Hercegovinë** dhe **Kroaci**).[86]

Një vit pas arritjes së paqes në **Marrëveshjes së Dejtonit**, në verë të vitit 1996, në Kosovë nisën shenjat e para të shfaqjes së lëvizjeve ushtarake të shqiptarëve të **Kosovës**: në disa vende u sulmuan caqet ushtarake e policore serbe të instaluara në vend.[87] Vetëm një vit pas kësaj, megjithatë, u bë shumë e qartë se **Kosova** po shkonte drejt dhunës dhe konfliktit të armatosur me forcat policore e ushtarake serbe për shkak se represioni po merrte përmasa dramatike dhe të padurueshme. Në nëntor të vitit 1997, me daljen në skenë të **UÇK**-së, nisi ajo që të gjithë e kishin pritur: konfrontimi i hapur në mes të popullit shumicë të **Kosovës** dhe forcave policore e ushtarake serbe të instaluara në vend. Konflikti i hapur në mes të **UÇK**-së dhe forcave serbe, pas dy vitesh e detyroi bashkësinë ndërkombëtare për t'u vënë në lëvizje. Lëvizja nisi gjatë verës së vitit 1997, për t'u intensifikuar në fund të atij

---

86 Cf. Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar. Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi* (KOHA: Prishtina, 2009) fq. 129-142; Marc Weller, "The Rambouillet Conference on Kosovo" *International Affairs* Volume 75, Issue 2 (April 1999) fq. 211-251 në fq. 218; Dimitar Bechev, *Rival Power: Russia's Influence in Southeast Europe*, fq.41-42; P. M. H. Bell & Mark Gilbert, *The World Since 1945: An International History*, fq. 468-471.

87 Noel Malcolm, *Kosovo. A Short History*, fq. 355.

viti dhe në fillim të vitit në vijim. Gjatë tërë vitit 1998, Serbia kishte thyer premtimet dhe marrëveshjet e lidhura më ndërmjetësim ndërkombëtar.

Bashkësia ndërkombëtare, në veçanti amerikanët, e kishin duruar Serbinë deri në fillim të vitit 1999. Pas masakrës së **Reçakut** në janar të vitit 1999, u bë fare e qartë se **Serbia e Millosheviqit** po synonte qëllimin e njëjtë si në **Bosnje-Hercegovinë** dhe **Kroaci**, përkatësisht përfitime territoriale me dhunë dhe përmes spastrimit etnik të kulturave e popujve jo serbë. Për të ndaluar një gjë të tillë, bashkësia ndërkombëtare, nën udhëheqjen e vendeve perëndimore dhe **Rusisë**, i a.q. **Grupi i Kontaktit**, thirri një konferencë ndërkombëtare për paqen në Kosovës, e cila u mbajt në **Rambuje** të **Francës**.[88] Kjo konferencë kishte për qëllim gjetjen e një zgjidhje paqësore rreth mospajtimeve serioze në mes të serbëve e shqiptarëve. Mospajtimet po rrezikonin paqen dhe sigurinë në rajon dhe më gjerë. **Konferenca e Rambujesë** ka mbaruar më datën 23 shkurt të vitit 1999 dhe ka prodhuar një dokument jashtëzakonisht të detajuar, që ka qenë rezultat i javëve të tëra të negocimit intesiv në mes të palëve në konflikt, atë që njihet si **Marrëveshja e Rambujesë**.

Nuk ishin vetëm negociatorët në **Rambuje** ata që kontribuuan në formësimin përfundimtar të tekstit të saj: shumë kohë para se ajo të përpilohej, **Komisioni i Venecias** pat marrë përsipër kryerjen e një vlerësimi të brendshëm dhe tërësisht konfidencial lidhur me pozitën kushtetuese të Kosovës dhe popullsisë së saj shumicë nën regjimin millosheviqian. Si pikë referimi për këtë vlerësim kishin qenë **Kushtetuta e Serbisë (**1990) dhe **Kushtetuta e Zhablakut (**1992), mirëpo vetëm aq sa ka qenë e domosdoshme për raportim dhe vlerësim të pozitës së Kosovës dhe popullsisë së saj shumicë në **RFJ**.[89] Ndërkaq, raporti që u prodhua, bënte vlerësime që kishin për qëllim për të shërbyer si një udhëzues për draftim, në kohën që po vinte, të një marrëveshjeje të paqes në mes të shqiptarëve të Kosovës dhe qeverisë së **Beogradit** si forcë sunduese.

Komisioni në këtë raport nuk pat lënë asnjë dyshim lidhur me pozitën e vështirë të popullsisë shumicë, statusin e saj inferior në pikëpamje kushtetuese dhe gjendjen e keqe të lirive dhe të drejtave njerëzore për shkak të diskriminimit serb intensiv. Me qëllim të daljes nga kjo gjendje e rëndë, ai raport vlerësonte se duhej propozuar vënia në jetë e standardeve të duhura ndërkombëtare lidhur mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive njerëzore, duke ndjekur rrugën e mishërimit të këtyre standardeve në tekstet kushtetuese të Kosovës në kohën që po vinte. Kjo qasje e Komisionit, në veçanti u vu në spikamë në pjesën e diskutimit lidhur me çështjen e vetëqeverisjes lokale, e cila u pa si një instrument kornizë që do të shërbente për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Kjo qasje, pak a shumë, u shndërrua në një udhëzues për draftuesit e **Marrëveshjes së Rambujesë**, si dhe i të gjitha teksteve të mëspatajme kushtetuese në **Kosovë** në kohën që po vinte, përfshirë këtu Kushtetutën e vitit 2008.

Marrëveshja e Rambujesë, siç do të shihet në vijim, ka përmbajtur dispozita kushtetuese që ishin të modeluara sipas vijave kryesore të skicuara në raportin e vlerësimit të Komisionit. Kjo është e qartë në veçanti kur flitet për dispozitat që rregullojnë organizimin e pushtetit dhe marrëdhëniet e pushtetit brenda territorit të Kosovës,[90] si dhe dispozitat lidhur me vendin dhe rolin e të drejtave dhe lirive njerëzore dhe të minoriteteve.[91] Thënë ndryshe, dispozitat e **Marrëveshjes së Rambujesë** parashikonin me saktësi të njëjtat standarde për vetëqeverisje lokale, mbrojtjen dhe promvimin e liritve dhe të drejtave të njeriut e të minoriteteve me ato që ishin parashikuar në raportin e vlerësimit të Komisionit. Kjo dilte nga fakti se vlerësimi i tij ishte bërë në gusht të vitit 1998, disa muaj para se të ndodhte **Konferenca e Rambujesë.**

---

88 Marc Weller, "The Rambouillet Conference on Kosovo", fq.227-238; Dimitar Bechev, *Rival Power: Russia's Influence in Southeast Europe*, fq.40-48.

89 European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Draft outline of main elements for an agreement on Kosovo*. **CONFIDENTIAL** (Council of Europe: Strasbourg, 31/08/98).

90 **Marrëveshja e Rambujesë**: Kuadri, neni I ["Parimet"], nën 4. Më pastaj, në **Kushtetutën e Rambujesë** në mënyrë të detajuar janë përcaktuar rregullat mbi organizimin e pushtetit në nivel të Kosovës si dhe marrdhëniet e këtij pushteti me **RFJ** dhe me **Republikën e Serbisë**.

91 **Marrëveshja e Rambujesë**: Kuadri, neni I ["Parimet"], nën 5. Më pastaj, në **Kushtetutën e Rambujesë** në mënyrë të detajuar janë përcaktuar rregullat mbi marrëdhëniet e pushtetit politik me individin, liritë dhe të drejtat e e njeriut dhe të komuniteteve, me fokus të veçantë respektimi i parimit të mosdiskriminimit dhe zbatimi i satndardeve më të larta ndërkombëtare mbi liritë dje të drejtat e njeriut.

Marrëveshja e Rambujesë, përkundër faktit që ka pasur një natyrë të përkohshme, përfaqëson një dokument shumë të elaboruar që kishte për qëllim parësor ndalimin e dhunës dhe të luftës në Kosovë si dhe krijimin e kushteve për themelimin e një autonomie substanciale në Kosovë. Si i tillë, ky dokument ka pasur karakter të dyfshit: prospektiv dhe retrospektiv. Ngjashëm me **Marrëveshjen e Dejtonit për Bosnje-Hercegovinën** (nëntor, 1995), **Marrëveshja e Rambujesë** ka ngërthyer një rrjet mjaft të detajuar të dispozitave me të cilat mëtohej rregullimi i të gjitha aspekteve të jetës në Kosovë pasi mbarimit të luftës, por edhe dispozita tjera që synonin nxitjen e ndryshimeve të menjëhershme në terren (ndalimi i dhunës dhe i luftës së armatosur në mes të palëve).

Ky dokument, megjithatë, nuk u jetësua asnjëherë si pasojë e refuzimit të tij nga ana e diktatorit serb **S. Milosheviq**, i cili vazhdoi me politikat e veprimit violent dhe represiv kundër popullsisë shumicë në Kosovë. Meqë shqiptarët nënshkruan dokumentin e Konferencës, kurse Serbia intensifikoj represionin dhe dhunën në **Kosovë**, kaq mjaftonte që të hapeshin dyert për sulme ushtarake të **NATO**-s kundër caqeve policore dhe ushtarake të **RFJ**-së me qëllim të ndërprerjes së mizorive që regjimi po bënte kundër popullsisë shqiptare, dhunës e terrorit që kishte marrë përmasa gjenocidale.[92] Fushata ajrore e **NATO**-s mbaroi pas 78 ditëve të sulmeve intensive kundër caqeve në tërë territorin e **RFJ**, dhe u pasua me futjen e trupave të **NATO**-s në Kosovë dhe themelimin e një administrate ndërkombëtare të përkohshme nën lidershipin e OKB-së, e njohur si administrata ndërkombëtare e **UNMIK**, bazuar në **Rezolutën 1244**.

Edhe pse nuk u jetësua asnjëherë si pasojë e dështimit serb për ta nënshkruar, ndërhyrjes ushtarake të NATO-s kundër RFJ dhe instalimit të administratës së UNMIK-ut në bazë të Rezolutës 1244 të, **Marrëveshja e Rambujesë** ka një rëndësi të madhe historike e praktike si tekst juridiko - kushtetues për shkak se ka pasur karakter ndërkombëtar, gjë që nuk ka qenë rasti me **Kushtetutën e Kaçanikut**. Kjo rëndësi shihet në dy aspekte:

- e para, sepse për herë të parë pas vitit 1974, **Kosovës** i njihet një identitet i qartë kushtetues në të gjitha aspektet e tij; dhe
- e dyta, sepse **Kosova** për herë të parë fiton një gjykatë kushtetuese të proveniencës perëndimore liberale të modeluar sipas sistemit **evropian/kelsenian**.

Pikërisht për këto dy arsye e shohim të rrugës që në vijim të diskutojmë këto aspekte të rëndësisë së këtij dokumenti kushtetues. Nuk ka rëndësi që kurrë nuk u zbatua në Kosovë. E rëndësishme është që dokumenti paraqet pjesë përbërëse të historisë kushtetuese të Kosovës. Shumë dispozita të saj, sikundër do të shihet, janë reflektuar dhe transportuar në të gjitha dokumentet kushtetuese të Kosovës pas çlirimit nga serbët (10 qershor 1999). Të tilla janë, ta zëmë, **Korniza Kushtetuese**[93] dhe Kushtetuta e vitit 2008. Këto aspekte kanë rëndësi dhe duhet të diskutohen në vijim, për arsyet si vijon:

- e para, sepse prekin identitetin kushtetues të Kosovës së sotme;
- e dyta, sepse kanë të bëjnë me vënien në jetë në Kosovë të standardeve ndërkombëtare dhe evropiane për promovimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të njeriut; dhe
- e treta, sepse kanë të bëjnë me vetë llojin e gjyqësisë së re kushtetuese që mëtohej të instalohej në Kosovë pas vënien në jetë të **Marrëveshjes së Rambujesë**, diçka që ka ndodhur vetëm pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Se **Marrëveshja e Rambujesë** po mëtonte ndërtimin nga hiçi të një identiteti të ri kushtetues të Kosovës, kjo vërehet nga dispozitat e saj kryesore dhe anekseve përbërëse. Që në preambulë flitej për synimin parësor të hartuesve: zgjidhjen paqësore dhe me mjete politike të statusit përfundimtar të Kosovës. Për të arritur këtë

---

92 Për rezistencën paqësore të popullit shumicë në Kosovë nga viti 1989 deri në fillim të vitit 1998, për luftën e viteve 1997-1998, për negociatat në **Rambuje**, përfshirë përpilimin e **Marrëveshjes së Rambujesë** (shkurt 1999), nënshkrimin e saj nga shqiptarët dhe refuzimin nga ana e serbëve, cf. më shumë në Marc Weller "Rambouillet Conference on Kosovo", fq. 211-251; Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar. Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*, fq. 189-254.

93 **Korniza Kushtetutese** ka hyrë në fuqi më 15 maj 2001, si **Rregullore e UNMIK-ut Nr. 2001/9**, dhe është shpallur nga ana e PSSP të OKB-së. Si e tillë, ka pasur cilësinë e një legjislacionii të autorizuar dhe të nxjerrë nga ana e UNMIK-ut konform **Rezolutës 1244** të KS të OKB-së dhe **Rregullores Nr. 01** të datës 15 korrik 1999. Ky dokument, i nxjerrë me synimin për të krijuar bazën e rendit kushtetues kosovar, ka pasur rangun dhe vlerën e njëjtë si rregulloret dhe aktet tjera të **UNMIK**-ut të nxjerra pas qershorit 1999 derimë shpalljen e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008.

qëllim, hartuesit e saj kishin paraparë themelimin e një sistemi vetëqeverisës në Kosovë, i cili do të zgjaste tri vjet pas nënshkrimit të saj.

Marrëveshja përbëhet nga dy pjesë: **pjesa kuadër** dhe **pjesa e shtojcave** që paraqet pjesë të saj.

Pjesa kuadër ka dy nene. Neni I ["Parimet Themelore"] fokusohet kryesisht në liritë dhe të drejtat e njeriut, duke parashikuar liri dhe të drejta shtesë për anëtarët e bashkësive nacionale. Ajo çfarë bie në sy është së në këtë periudhë kalimtare, Marrëveshja kishte parashikuar të drejtën e qytetarëve të Kosovës për t'i adresuar ankesat e tyre lidhur me lirët dhe të drejtat e njeriut pranë organeve dhe institucioneve relevante ndërkombëtare. Përveç kësaj, mosdiskriminimi dhe barazia e të gjithëve përcaktohej si një ndër shtyllat kryesore të sistemit vetëqeverisës në **Kosovë**, kurse zgjidhjet e lira dhe të ndershme duhej të ishin mënyra e vetme e formimit të vullnetit kolektiv në vend.

Liritë dhe të drejtat e njeriut dhe formimi i këtij vullnetit politik, pa asnjë diskriminim, duhej të realizohej pa ndërhyrjen e autoriteteve të **RFJ** dhe të **Republikës së Serbisë**. Kjo ishte kështu për shkak se, sipas parimeve themelore dhe vetë tekstit të **Marrëveshjes së Rambujesë**, zgjidhja e përkohshme nuk prekte sovranitetin federal mbi Kosovën: integriteti dhe sovraniteti territorial i **RFJ** ngelej i paprekur dhe i garantuar. Kjo dispozitë, megjithatë, vlente vetëm deri në zgjidhjen e statusit final të Kosovës.

Kushtetuta e Kosovës, si shtojcë e parë e **Marrëveshjes së Rambujesë**, shërbente si një pikë referimi për realizimin e lirive dhe të drejtave njerëzore dhe për mënyrën e ushtrimit të pushtetit. Në rast të konfliktit (mospajtimit) në mes tyre, Marrëveshja kishte epërsi. Kjo është e kuptueshme nëse kihet parasysh fakti se, njëjtë si në rastin e **Marrëveshjes së Dejtonit**, ky dokument përbënte shtojcë të saj, e cila ishte e vetmja që posedonte cilësinë e dokumentit me garancione ndërkombëtare.

Neni i II ["Masat e Ndërtimit të Besimit"] ka folur për ndalimin e përdorimit të forcës, duke shërbyer si një kuadër për zgjidhjen e çështjeve që kishin të bënin me konfliktin e armatosur në Kosovë. Ndër këto çështje kanë qenë: refugjatët dhe personat e zhvendosur, kthimi i tyre nëpër vatrat e veta, personat e zhdukur dhe të kidnapuar, amnistia e atyre që kanë marrë pjesë në konfliktin e armatosur në Kosovë, ndihma ndërkombëtare për rindërtimin e vendit dhe, në fund, themelimi i medieve të lira dhe të pavarura kosovare. Sikundër u tha më sipër, pjesa kuadër e Marrëveshjes operacionalizohej përmes shtojcave, të cilat kanë qenë pjesë e pandashme e saj.[94]

---

[94] Autori i parë i këtij libri ka shërbyer si këshilltar ligjor i **Delegacionit të Kosovës në Konferencën e Rambujesë,** e cila u mbajt në qytetin e **Rambujesë** afër **Parisit** nga data 6 shkurt deri më 23 shkurt 1999. Në aspektin formal, ndërkaq, **Marrëveshja e Rambujesë** është nënshkruar në Paris më datën 18 mars 1999 për shkak se asnjera palë nuk qe e gatshme për nënshkrim ditën e mbylljes së Konerencës. Në fakt, konferenca qe parashikuar të mbyllet në mesditë të datës 20 shkurt 1999, por qe shtyrë për tri ditë nënshkrimi i saj. Kur u pa që as atë ditë nuk mund të bëhej nënshkrimi i saj, organizatorët e Konferenës, **Grupi i Kontaktit** (i përbër nga SHBA-të, Britania e Madhe, Rusia, Franca, Gjermnaia dhe Italia) e shtynë të njejtën për datën 15 mars 1999.
Autori i ka të freskëta kujtimet rreth punës aty, kur secila shtojcë e darft-**Marrëveshjes për Paqe** është diskutuar me secilin delegacion veç e veç gjatë një dite së paku, për t'u përcjellë ditën në vijim te pala tjetër, kurse në fund të punimeve të Konferencës, ndërmjetësuesit ndërkoimbëtar e kanë prezantuar para secilës palë veç e veç për miratim tekstin përfundimtar. Në fund të bisedimeve paqësore në **Rambuje,** më datën 19 shkurt 1999, ishte planifikuar të bëhej nënshkrimi përfundimtar i marrëveshjes. Me atë rast, serbët nuk pranuan të nënshkruanin tekstin e draft-marrëveshjes, kurse pala kosovare kërkoj një afat shtesë për nënshkrimin e saj, një raund të dytë të bisedimeve. Ky afat u shty për një muaj.
Në raundin e dytë të bisedimeve, të mbajtura në Paris nga data 15 deri 18 mars 1999, shqiptarët nënshkruan tekstin e **Marrëveshjes së Rambujesë**, të ofruar na ndërmejtësuesit ndërkombëtarë, më datën 18 mars 1999. Serbët ngulën këmbë për mos nënshkrim të saj ani se kishin marrë pjesë aktive në bisedimet e paqes. Kjo rrethanë shërbeu si shkas imediat për nisjen e sulemeve të **NATO**-s kundër caqeve serbe (24 mars – 10 qershor 1999). Kjo pati për pasojë kapitullimin e Serbisë dhe hyrjen e trupave të **NATO**-s dhe të **UÇK-së** në Kosovë më datën 10 qershoir 1999. Kjo nuk nënkuptonte, megjitahtë, se **Marrëveshja e Rambujesë** kishte vdekur: **Rezoluta 1244** e mori atë për bazë për ndërtimin e sistemit të ri të vetëqeverisjes në **Kosovë** deri në arritjen e një marrëveshjeje politike në mes të palëve lidhur me statusin përfundimtar të **Kosovës.** Për këtë flasim sërish më vonë. Për një studim analitik dhe me kompetencë në aspektin juridiko-ndërkombëtare, origjinal deri në fund, të **Konferencës së Rambujesë**, cf. punimin e njërit prej këshilltarëve ndërkombëtarë të e **Delegacionit të Kosovës**, Marc Weller, "The Rambouillet Conference on Kosovo", fq. 211–251 (ku autori diskuton aspektet juridiko-ndërkombëtare dhe juridiko kushtetuese të Konferencës, duke u fokusuar në veçanti në ndryshimet fiundamentale në rolin e akterëve ndërkombëtar në krizën e Kosovës, në luftën në mes të vlerave themelore të rendit ndërkombëtar dhe zgjidhjes së statusit të Kosovës dhe, në fund, në legjitimitetin e kërcnimit me forcë dhe përdorimit të forcës në konteksktin e ndërprejes së dhunës dhe krizës humanitare në Kosovë); Për diskutimin në detaje të draftit sipas shtojcave dhe sjelljen fillestare të **Delegacionit Kosovar**, cf. ibid. fq. 227-232; Për bojkotin e **Delegacionit serb** dhe sjelljen e tyre të pahijshme gjatë **Konferencës së Rambujesë** si dhe dërgimin e forcave të mëdha ushtarake e policore në **Kosovë** gjatë bisedimeve të **Rambujesë** dhe **Parisit** me qëllim të shkatërrimit të rezistencës dhe dëbimit masiv të kosovarëve, cf. Ibid. fq. 228-229 & 234-236.

Si shtojcë e parë, siç u tha më sipër, na paraqitet **Kushtetuta e Kosovës**, përkatësisht **Kushtetuta e Rambujesë**, e cila ka pasur preambulën dhe vetëm 11 nene.

Njëjtë si në rastin e **Kushtetutës së Bosnje-Hercegovinës**, e cila është pjesë e **Marrëveshjes së Dejtonit**, kjo kushtetutë ka qenë e paramenduar të jetë pjesë e një marrëveshjeje ndërkombëtare, **Marrëveshjes së Rambujesë**. Një gjë e tillë nënkupton se normat e kësaj të fundit (Marrëveshjes) do të duhej të kishin epërsi (superioritet) ndaj stipulimeve të Kushtetutës. Kjo bëhet e qartë qysh në nenin e parë të saj, që bënte fjalë për parimet e vetëqeverisjes në Kosovë. Aty thuhej se vetëqeverisja ushtrohej në pajtim me kushtet e përcaktuara në Marrëveshje, përmes organeve legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore, si dhe përmes organeve e institucioneve të tjera të përcaktuara aty.

Pjesët tjera të këtij neni kanë bërë fjalë për të drejtat e njeriut dhe të komuniteteve nacionale në Kosovë, marrëdhëniet e kësaj të fundit me **RFJ** dhe **Serbinë**, në veçanti në sferën e politikës së jashtme dhe çështjeve që kanë të bëjnë me sovranitetin dhe integritetin territorial të **RFJ**-së, pandryshueshmërinë e kufijve të **Kosovës**, si dhe çështje të tjera lidhur me to.

Neni i dytë ka bërë fjalë për organin legjislativ - **Kuvendin e Kosovës.** Ky organ parashikohej t'i ketë 120 (njëqind e njëzet) anëtarë, nga të cilët 80 (tetëdhjetë) do të zgjidheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë, kurse 40 (dyzetë) të tjerët do të ndaheshin në mes të bashkësive nacionale.

Neni i tretë dhe i katër kanë bërë fjalë për kryetarin, qeverinë dhe administratën e **Kosovës**, kurse neni i pestë në pjesën e tij të përgjithshme e ka futur **Gjykatën Kushtetuese të Kosovës** në kuadër të pushtetit gjyqësor kosovar. Në hierarkinë gjyqësore, megjithatë, nuk ka bërë pjesë Gjykata Kushtetuese. Kjo shihet në faktin se ekzistonin vetëm tri nivele të gjyqësorit kosovar: **Gjykata Supreme e Kosovës**, gjykatat e qarkut dhe gjykatat komunale.

Përbërja dhe juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese përcaktohej me pikat 5-8 të nenit të pestë. Ajo duhej të kishte nëntë gjyqtarë, ku secili nga bashkësitë nacionale të Kosovës do ta kishte nga një, kurse pesë gjyqtarët tjerë qe përcaktuar se do të duhej të përzgjidheshin nga kryetari i **GJEDNJ**.

Juridiksioni përcaktohej me pikën e gjashtë ku thuhej se autoriteti i saj shtrihej ndaj mosmarrëveshjeve që kanë të bëjnë me interpretimin e kuptimit të kushtetutës. Kjo do të thotë se fjala ka qenë për një gjykatë që do të duhej ta kishte autoritetin parësor në interpretimin e kushtetutës. Ky autoritet ka pasur të bëjë në rend të parë me konstatimin nëse ligjet e aplikueshme në Kosovë, vendimet apo aktet e kryetarit të Kosovës, të qeverisë, të komunave apo të bashkive nacionale ishin në përputhshmëri me kushtetutën. Ky autoritet nuk kufizohej vetëm në këto që u thanë më sipër. Kjo shihej nga pika e tetë e këtij neni që përcaktonte se juridiksioni i saj shtesë mund të përcaktohej me Marrëveshje dhe me ligj. Jo vetëm kaq: në pjesën e këtij neni që fliste për funksionimin e gjykatave, pikat 11-15, përcaktohej qartë se gjyqtarët në Kosovë mund të shkarkoheshin vetëm pas dhënies së pëlqimit paraprak nga Gjykata Kushtetuese (pika 13).

Palët e autorizuara normoheshin me pikën gjashtë, nën germën "a" dhe "b", dhe pikën shtatë të nenit si më sipër. Si palë të tilla mund të paraqiteshin:

- kryetari i Kosovës, kryetari dhe nënkryetarët e Kuvendit të Kosovës;
- avokati i popullit;
- kuvendet dhe këshillat e komunave;
- secila bashkësi nacionale në pajtim me rregullat demokratike;
- çdo gjykatë e rregullt në rastet kur gjatë zgjidhjes së një çështje pranë saj has në një çështje e cila bie në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese (kontrolli incidental); dhe, së fundi,
- individët në ato raste kur konsiderojnë së janë viktimë e cenimit të të drejtave dhe lirive njerëzore si dhe të atyre të drejtave e lirive që u takojnë bashkësive nacionale, mirëpo pasi t'i kenë shterur të gjitha mjetet tjera juridike.

Nenet tjera të **Kushtetutës së Rambujesë** flisnin për çështjet lidhur me funksionimin e komunave (neni tetë); përfaqësimin e Kosovës në **RFJ** dhe në **Republikën e Serbisë** (neni nëntë); formën dhe përmbajtjen e amendamentimit (neni dhjetë); dhe, në fund fare, hyrjen e saj në fuqi (neni i njëmbëdhjetë).

Kapitujt tjerë, si shtojca të **Marrëveshjes së Rambujesë**, të cilët nuk i diskutojmë në mënyrë të detajuar në këtë libër, kanë pasur të bëjnë me sa vijon:

- kapitulli 2 ["Sigurimi publik policor dhe civil"];
- kapitulli 3 ["Zhvillimi dhe mbikëqyrja e zgjedhjeve"];
- kapitulli 4 ["Çështjet ekonomike"];
- kapitulli 5 ["Implementimi I"];
- kapitulli 6 ["Ombudsmani"];
- kapitulli 7 ["Implementimi II"]; dhe, së fundi,
- kapitulli 8 ["Amendamentimi, vlerësimet gjithëpërfshirëse dhe dispozitat përfundimtare"]

Në pikën e tretë të nenit të parë të kapitullit të tetë dhe të fundit të **Marrëveshjes së Rambujesë** gjendet dispozita famoze që për herë të parë i njihte Kosovës ndërkombëtarisht të drejtën e vendosjes për fatin e saj politik. Në këtë pikë thuhej se pas tri vjetësh do të ndërtohej një mekanizëm për zgjidhjen përfundimtare të statusit të Kosovës në një tubim të sërishëm ndërkombëtar. Ky mekanizëm përcaktohej se do të kishte për detyrë të merrte këto kritere parasysh me rastin e vendosjes për statusin përfundimtar të Kosovës:

- vullnetin e popullit;
- mendimin autoriteteve relevante ndërkombëtare;
- kontributin e palëve në impelementimin e **Marrëveshjes së Rambujesë**; dhe, së fundi,
- **Aktin Final i Helsinkit**.

Mbi bazën e këtyre kritereve, në këtë nen thuhej se bashkësia ndërkombëtare, pas tri vjetësh do të bënte një vlerësim të tërësishëm të implementimit të **Marrëveshjes së Rambujesë**, duke marrë parasysh propozimet e palëve për çdo masë tjetër shtesë. Kjo, megjithatë, nuk u bë asnjëherë sepse serbët nuk nënshkruan **Marrëveshjen e Paqes** dhe pasoi bombardimi i **NATO**-s për të ndaluar makinerinë agresive dhe brutale ushtarako - policore dhe paramilitare të diktatorit **S. Milloshevic** për të kryer edhe një gjenocid të ri në **Kosovë** kundër popullsisë së saj shumicë. Vetëm disa vite më vonë do të vihej në lëvizje ideja e një mekanizmi për zgjidhjen e statusit të Kosovës, siç ishte parashikuar në **Rambuje**: vënia në jetë e kësaj ideje nisi me një vlerësim të gjithanshëm të bërë nga ndërmjetësuesi ndërkombëtar, diplomati norvegjez **Kai Aide**, në raportin e tij të vitit 2004 të cilin e kishte përpiluar sipas mandatit të dhënë nga Sekretari i Përgjithshëm i **OKB**-së. Mbi bazën e këtij raporti nisën bisedimet ndërkombëtarisht të autorizuara dhe ndërmjetësuara për zgjidhjen e statusit politik të **Kosovës**. Për këtë dhe çështjet lidhur me këto flasim në vijim të këtij shkrimi.

T'i kthehemi tani çështjes së lirive dhe të drejtave të njeriut të përmbajtura në të gjitha dokumentet kushtetuese të Kosovës, të nxjerra pas mbarimit të **Luftës së Ftohtë**.

Nga dokumentet kushtetuese të diskutuara si më sipër që kanë të bëjnë me kohën pas **Luftës së Ftohtë**, qofshin ato të miratuara nga vetë kosovarët apo me ndërmjetësimin ndërkombëtar, sanksionohen aspekte të rëndësishme kushtetuese të Kosovës që janë me rëndësi për historinë kushtetuese të **Kosovës**, siç janë: synimi për një rregullim shtetëror të **Kosovës** si një demokraci parlamentare kushtetuese, ndarja dhe balansimi i pushteteve, pavarësia e gjyqësorit dhe e organeve të drejtësisë, ekzistimi i agjensioneve të pavarura për të ushtruar disa nga funksionet administrative të shtetit kosovar dhe kështu me radhë.

Ndër aspektet më të rëndësishme që sanksionoheshin në secilin prej dokumenteve si më sipër është ai që ka të bëjë me liritë dhe të drejtat e njeriut. Ky aspekt përbën ndër shtyllat kryesore të identitetit kushtetues të Kosovës së re, të pavarur dhe sovrane, i cili ka nisur të ndërtohet në mënyrë graduale që nga mbarimi i **Luftës së Ftoftë**, duke filluar me **Kushtetutën e Kaçanikut** e deri te Kushtetuta e vitit 2008. Të shohim si janë reflektuar këto në tekstin e **Marrëveshjes së Rambujesë**, meqenëse për liritë dhe të drejtat e njeriut në **Kushtetutën e Kaçanikut** folëm më sipër.

Të drejtat dhe liritë themelore sipas përcaktimit të nenit gjashtë ["Të Drejtat dhe Liritë e Njeriut"] dhe shtatë ["Bashkësitë Nacionale "] të **Kushtetutës së Rambujesë** paraqesin modelin pararendës, që më vonë do të ndiqet nga **Korniza Kushtetuese** (2001) dhe **Kushtetuta e Kosovës** (2008). Në sferën e lirive

dhe të drejatve të njeriut dhe të asaj që tani quhen komunitetet e Kosovës, me këtë kushtetutë, në fakt, nis faza e parë të ndërtimit të identitetit të ri efektiv kushtetues të Kosovës, identitet që aspak nuk përputhet me kulturën materiale të shoqërisë kosovare në të gjitha fazat e zhvillimit të saj në të kaluarën. I vetmi dallim është në terminologji, sepse konceptualisht asnjë dallim substancial nuk ekziston: në ndërkohë që në **Kushtetutën e Rambujesë** është përdor fjala "bashkësi nacionale", në Kushtetutën e vitit 2008 flitet për "komunitetet " dhe përfshinë jo vetëm komunitetet nacionale por edhe ato etnike, gjuhësore, fetare dhe komunitetet tjera.

Kushtetuta e Rambujesë nuk ka qenë aq e gjerë në sferën e lirive dhe të drejtave e lirive fundamentale. Nenet gjashtë dhe shtatë nuk kanë parashikuar një listë të dokumenteve ndërkombëtare që do të zbatoheshin në **Kosovë** pas mbarimit të luftës dhe konfliktit të armatosur. I vetmi përjashtim në këtë aspekt ka qenë **KEDNJ** dhe protokollet e saj, të cilat, sipas pikës së dytë të nenit gjashtë, do të zbatoheshin drejtpërsëdrejti në **Kosovë**. Përveç këtij instrumenti ndërkombëtar, **Marrëveshja e Rambujesë** në pikën e parë të nenit të njëjtë, lidhur liritë dhe të drejtat themelore përdor një formulim i cili pas luftës do të përsëritet në dokumentet relevante kushtetuese. Ai formulim është si vijon:

"[...] Të gjitha autoritet publike në Kosovë do të përkujdesen për vënien në jetë të drejtat e liritë njerëzore, të cilat ndërkombëtarisht janë të pranuara".

Të drejtat dhe liritë e stipuluara në këtë mënyrë parashihej të kishin supremaci (epërsi) ndaj çdo ligji tjetër që mund të ishte i zbatueshëm në territorin e Kosovës.

Të drejtat e bashkësive nacionale, në anën tjetër, sipas nenit shtatë, pika e parë, të **Kushtetutës së Rambujesë** kanë qenë të koncipuara si të drejta dhe liri shtesë me qëllim që atyre t'iu mundësohej ruajtja dhe kultivimi i identitetit nacional, kulturor, fetar dhe gjuhësor në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe **Aktin Final të Helsinkit**. Kjo qasje e largimit radikal nga e kaluara nuk ka pasur për qëllim ruajtjen e traditave dhe zakoneve ekzistuese nga e kaluara e as ruajtjen e aspekteve tjera të strukturës kulturore materiale të shoqërisë kosovare, të cilat kishin qenë pjesë përbërëse e historisë së kaluar dhe mjaft tragjike të **Kosovës**. Kjo qasje, përkundrazi, ka qenë një veprim i vetëdijshëm dhe i kryer me ndërgjegje me qëllim të largimit të **Kosovës** nga e kaluara e saj tragjike dhe trashëgimia e hidhur socio-kulturore, politike dhe tjetër. Se kjo është kështu u pa pas luftës së Kosovës, kur më konkretisht u sqaruan burimet kosovare për të liritë dhe të drejtat e njeriut, ashtu siç kishte vepruar **Afrika e Jugut** kur kishte refuzuar regjimin e **Apartheid**-it dhe përqafimin në të njëjtën kohë të vlerave, parimeve, normave dhe zakoneve bazë të shoqërive liberale perëndimore.[95]

Kjo shkëputje me të kaluarën, një shkëputje krejt radikale, pra, u ndoq me qartë pas luftës dhe u reflektua në të gjitha tekstet kushtetuese të Kosovës. Këtë do ta shohim në rreshtat në vijim të këtij seksioni. Me këtë qasje, **Kosova** pas luftës i dha përparësi absolute të drejtës ndërkombëtar mbi liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, duke e bërë këtë të drejtë një normë kushtetuese vendore. Kjo është kështu sepse **Kushtetuta e Rambujesë** sikur e la disi të paqartë çështjen e burimeve të së drejtës në lëmin e të drejtave dhe lirive fundamentale të individit. Aty fare nuk përmenden se cilat instrumente regjionale dhe universale janë të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë në **Kosovë** si norma me karakter superior kushtetues.

---

[95] Për dallimin në mes të **kushtetutave tranformative** dhe **jo tranformative**, shih më shumë në: Cass R. Sunsstein, *Designing Democracy: What Constitutions Do* (Oxford University Press: Oxford, 2001) fq. 67-68; Juan E. Mendez, "Constitutionalism and Transitional Justice." Në Michel Rosenfeld and Andras Sajo (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law,* fq. 1282-1285. Duhet të theksohet se, megjithatë, **Cass R. Sunstein** i konsideron si ruajtëse të traditave të kaluara të gjitha kushtetutat e vendeve ish-komuniste të **Evropës**. Kjo sepse, siç e thotç ai vetë, "ato provojnë të ndërtohen mbi botëkuptimet që paradatojnë komunizmin". Ibid.68.
Ky botëkuptim është gabim, natyrisht: dallimi në mes të dy llojeve të bazohet në atë nëse kushtetutat synojnë të ruajnë traditat e mëparshme individuale, pra jo traditat e kulturave dhe civilizimeve të tjera. Sikur të ishte kështu, atëherë çdo kushtetutë e vendeve të botës së tretë dhe kushtetutat evendeve tjera të modeluara sipas standardeve përëndimore mbi demokracinë kushtetuese pas rënies së sistemeve të tyre totalitare do të konsideroheshin si kushtetuta që ruajnë (konservojnë) të kaluarën. Këto vende, si p.sh. **Spanja**, **Portugalia**, **Greqia** etj., apo të tjerat si **Kili**, **Nikaragua, Hondurasi**, **Angola**, **Mozambiku** etj., do të cilësoheshin si kushtetuta ruajtëse (konservuese) të traditave të kaluara, përkundër faktit se tërë përpjkejet e tyre kanë qenë që të shkëputen nga e kaluara e tyre totalitare.

Për herë të parë në mënyrë shprehimore, prioriteti i të drejtës ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut u trajtua në **Kornizën Kushtetuese**, një derivat i autoritetit të KS të OKB-së sipas **Rezolutës 1244**. Për dallim nga **Kushtetuta e Rambujesë,** që kishte njohur supremacinë (epërsinë) e standardeve të njohura ndërkombëtarisht mbi të drejtat e njeriut ndaj çdo ligji vendor, **Korniza Kushtetuese** specifikonte një nga një tekstet ndërkombëtare, të cilat do të kishin një supremaci (epërsi) ndaj legjislacionit vendor në lëmin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Me fjalë të tjera, në ndërkohë që **Kushtetuta e Rambujesë** përdorte vetëm shprehje abstrakte sipas të cilave autoritetet publike në Kosovë detyroheshin të sigurojnë supremainë (epërsinë) e standardeve të njohura ndërkombëtarisht mbi të drejtat dhe liritë njerëzore, **Korniza Kushtetuese** specifikonte një nga një instrumentet ndërkombëtare që duheshin vënë në jetë nga secili autoritet publik kosovar me rastin e trajtimit të rasteve të lirive dhe të drejtave njerëzore. Kjo përfshinte jo vetëm të drejtat e liritë individuale por edhe ato që u përkisnin komuniteteve kosovare. Një zgjidhje si kjo, pra, specifikimi i instrumenteve ndërkombëtare të cilat do të zbatoheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë në **Kosovë** nga secili autoritet publik me rastin e adresimit të çështjeve të lirive dhe të drejtave njerëzore, individuale dhe kolektive, është përqafuar nga Kushtetuta e vitit 2008. Kjo vërehet nëse krahasohen dispozitat mbi liritë dhe të drejtat njerëzore të **Kornizës Kushtetuese** me dispozitat e kapitujve II [“Të Drejtat dhe Liritë Themelore’] dhe III [“Të Drejtat e Komuniteteve dhe Anëtarëve të Tyre”] të Kushtetutës së vitit 2008.

Në të njëjtën kohë, me **Kornizën Kushtetuese** për herë të parë parashikohet zbatimi i drejtpërdrejtë[96] dhe i tërthortë i marrëveshjeve ndërkombëtare mbi liritë dhe të drejtat e njeriut në tërë territorin e Kosovës.[97] Kjo ngjashmëri me Kushtetutën e vitit 2008 daton që nga zgjidhjet e dhëna në nenet e sipër cekura, gjashtë dhe shtatë, të **Kushtetutës së Rambujesë**.[98] Kjo nënkupton, me fjalë të tjera, se **Kushtetuta e Rambujesë** ka nisur internacionalizimin përmes kushtetutës të normave ndërkombëtare mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, mirëpo pa i specifikuar instrumentet konkrete që do të shërbenin si burime të së drejtës kushtetuese kosovare në lëmin e lirive dhe të drejtave të njeriut. Këtë e bëri **Korniza Kushtetuese**, duke ngërthyer dispozita që internacionalizonin instrumentet e caktuara regjionale dhe universale mbi të drejtat e liritë fundamentale të individit me qëllim që të njëjtat të shërbenin si e drejtë kushtetuese që do të ndihmonte tranzicionin në Kosovë në drejtim të ndërtimit të një demokracie të mirëfilltë kushtetuese. Përmes këtyre dy dokumenteve, instrumentet regjionale dhe ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut u bënë e drejtë e Kosovës në tranzicion dhe mjet për ndryshim të shoqërisë kosovare përgjatë vijave të konstitucionalizmit perëndimor, krahas dispozitave mbi organizimin e pushtetit në Kosovë. Në aspektin e gjyqësisë kushtetuese, ndërkaq, **Kushtetuta e Rambujesë** ka qenë shumë më e avancuar se **Korniza Kushtetuese**. Për këtë flasim sërish më vonë kur diskutojmë për **Kornizën Kushtetuese**. T’i kthehemi sërish temës së lirive dhe të drejtave të njeriut si moto e **Kornizës Kushtetuese** për ndërtimin e rendit të ri kushtetues kosovar, pa çka se nuk u vu në jetë ndonjë mekanizëm për zbatimin e dispozitave të saj që përbënin kartën mbi të drejtat dhe liritë njerëzore.

---

96 Zbatimi i drejtpërdrejtë i normave ndërkombëtare është ngushtë i lidhur me kuptimin e vetekzekutimit të normës së dhënë, pa marrë parasysh burimin e saj. Kjo është logike sepse një rregull zbatohet vetëm nëse ka përmbajtje normative. Kjo do të thotë se një normë ndërkombëtare, e cila gjendet në një marrëveshje ndërkombëtare, zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë vetëm nëse ka natyrë të vetekzekutueshme. Mbi zbatimin e drejtpërdrejtë të normave ndërkombëtare në aspektin komparativ, shih më shumë në Anne Peters and Ulrich K Press, “International relations and international law”. Në Mark Tushnet, Thomas Fleiner and Cheryl Saunders (eds.), *Rutledge Handbook of Constitutional Law*, fq. 33-43.

97 Zbatimi i tërthortë është i lidhur ngushtë me interpretimin e tekstit të dhënë kushtetues, gjë që nënkupton se njënormë ndërkombëtare zbatohet në mënyrë të tërthortë jo për shkak se paraqet një detyrim juridik për institucionet vendore por për shkak të faktit se një interpretim i normave vendore (kushtetuese dhe ligjore) bëhet duke marrë parasysh normat dhe standardet e të drejtës ndërkombëtare. Mbi zbatimin e tërthortë të normave ndërkombëtare nga aspekti komparativ, shih më shumë në: Anne Peters and Ulrich K Press, “International relations and international law”, fq. 33-43.

98 Për një analizë të hollë të kësaj materje, shih tek Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar:Administrimi nderkombetar i luftës së Kosoves për pavarësi*, fq. 391-420.

Në vijim si më sipër, **Korniza Kushtetuese** në nenin 3.2 ["Të drejtat e njeriut"] theksonte si vijon:

"Institucionet e Pavarura të Vetëqeverisjes respektojnë dhe sigurojnë zbatimin e të drejtave e lirive të individit të njohura ndërkombëtarisht, përfshirë ato që parashihen në:

(a) Deklaratën Universale mbi të Drejtat e Njeriut;
(b) Konventën Evropiane për të Drejtat e Liritë e Njeriut dhe protokollet e saj;
(c) Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike dhe protokollet e saj;
(d) Konventën Evropiane për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial;
(e) Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave;
(f) Konventa për të Drejtat e Fëmijëve;
(g) Karta Evropiane për Gjuhët Regjionale dhe të Minoriteteve; dhe
(h) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Nacionale".

Menjëherë pas këtij stipulimi normohej mënyra e zbatimit të tyre nga ana e autoriteteve publike kosovare, duke përcaktuar qartë se "[...] dispozitat mbi të drejtat dhe liritë e parapara në këto instrumente zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kosovë si pjesë e kësaj **Kornize Kushtetuese**".[99] Ky stipulim, megjithatë, nuk ka arritur asnjëherë që të krijojë një efekt praktik të këtyre instrumenteve, sado që logjika mund të shpie në argumentimin se instrumentet e tilla kanë mund të kenë një efekt të tillë. Kjo situatë në të cilën efekti praktik i drejtpërdrejtë i këtyre instrumenteve ka munguar gjatë tërë kohën sa ishte në fuqi ky dokument kushtetues ka ekzistuar edhe më herët, para se të nxirrej Korniza Kushtetuese: dispozitat e **Rregullores 1999/24**, të cilën e diskutojmë në vijim të këtij seksioni, stipulonte qasje afërsisht të njëjtë, përkatësisht synonte që e drejta ndërkombëtare mbi të drejtat dhe liritë njerëzore të konsiderohej si e zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë në tërë territorin e Kosovës. Kjo mbase ka mundur të bëhet kur flitet për ato norma që kishin natyrën e normave të vetekzekutueshme: zbatimi i tyre i tërthortë përmes interpretimit të tyre konform standardeve të njohura ndërkombëtarisht mbi liritë dhe të drejtat njerëzore përbënte një detyrim, që tani buronte jo vetëm nga neni 3.2 si më sipër, por edhe nga rregullativa tjetër e nxjerrë nga **UNMIK**-u gjatë kohës sa ka administruar efektivisht me Kosovën.[100]

Normat ndërkombëtare mbi të drejtat dhe liritë njerëzore kanë qenë pjesë përbërëse e rendit juridik kosovar që nga nxjerrja e rregulloreve të ndryshme të **UNMIK**-ut, të cilat si tërësi kishin për qëllimin reformimin e sistemit juridik-kushtetues sipas standardeve më të larta ndërkombëtare të demokracive kushtetuese. Si zbatimi i drejtpërdrejtë ashtu dhe ai i tërthortë, përmes interpretimit të teksteve juridike të rëndësisë kushtetuese, nuk kanë qenë kontestuese sepse ky zbatim ka qenë një detyrim kushtetues për të gjitha autoriteteve publike kosovare. Në praktikë, megjithatë, situata ka qenë më ndryshe: të pakët kanë qenë institucionet e Kosovës që kanë marrë seriozisht vënien në jetë të një detyrimi të tillë. Kjo gjendje nuk pati ndonjë përmirësim as me inicimin e projektit të a.q. **Standardet para Statusit** (dhjetor të vitit 2003).

Me këtë projekt, të nisur nga **Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm** (PSSP), autoritetet e **UNMIK**-ut synonin implementimin e një kulture të gjallë për liritë dhe të drejtat e njeriut në institucionet vendore dhe në akterët tjerë vendorë me qëllim që në një afat

---

[99] Neni 3.3 ["Të Drejtat e Njeriut"] i Kornizës.

[100] Po aq e rëndësishme është edhe rregullorja e UNMIK-ut që ka të bëjë me të drejtat dhe liritë fundamentale të individit, **Rregullorja Nr. 24/1999** mbi Ligjin e Aplikueshëm në Kosovë e datës 12 dhjetor 1999. Në seksionin 1.3 lidhur me "ligjin e zbatueshëm", Rregullorja përdorte të njejtin formulim si neni 3.2 i **Kornizës Kushtetuese,** duke listuar gati të njejtat instrumente ndërkombëtare si burim të ligjit mbi të drejtat e njeriut në Kosovë. I vetmi përjashtim është se kjo rregullore listonte nën germën "d", përveç instrumenteve nga neni 3.2 i **Kornizës Kushtetuese** edhe Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore të 16 dhjetorit 1966.

të mesëm të vinte deri te mbjellja e një demokracie kushtetuese kosovare.[101] Këto përpjekje kësisoj, në një mënyrë ose tjetër, bëheshin me qëllim që të fitohej kohë, përkatësisht me synim që të shtyhej sa më shumë që të jetë e mundur zgjidhja e statusit përfundimtar të Kosovës, gjithnjë me shpresë se, pas një kohe të zbatimit të këtyre standardeve, mund të vijë deri të krijimi i një klime tjetër më e favorshme për negociata rreth statusit. Kjo shpërputhje në mes të realitetit të normave dhe përpjekjeve të **UNMIK**-ut për realizimin e projektit **Standardet para Statusit** u pa hapur kur ndodhën ngjarjet tragjike të marsit 2004, të cilat, gjithashtu, i diskutojmë në vijim të këtij seksioni.

10.3. Periudha nën administrimin ndërkombëtar deri te shpallja e pavarësisë

Për zhvillimin e të drejtës kushtetuese kosovare në këtë periudhë me rëndësi janë këto dokumente:[102]

- **Rezoluta 1244**
- **Rregullorja nr. 1999/1**[103]
- **Rregullorja nr. 1999/24**[104]
- **Korniza Kushtetuese**
- **Raporti i Kai Eide** (2004)[105]
- **Plani Ahtisari**

---

[101] Në dhjetor të vitit 2003, bashkësia ndërkombëtare përmes PSSP, zt. **Hari Holker** (Harri Holkeri (1937-2011), i cili ka shëbryer si shef i **UNMIK**-ut gjatë viteve 2003-2004, ua dorëzoi autoriteteve kosovare dokumentin **Standardet për Kosovën**. Dokumenti përmbante detyrat kryesore qe Kosova duhej t'i realizonte deri ne vitin 2005, ne mënyrë qe pastaj të vlerësoheshin arritjet dhe nëse gjykohet se "standardet janë përmbushur", do te iniciohej faza e ardhshme e përcaktimit te statusit final te **Kosovës**. Në ballinën e këtij dokumenti shkruante që synohej krijimi, **inter alia**, i një Kosove ku të gjithë, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, racën ose fenë, janë të lirë të jetojnë, punojnë dhe udhëtojnë pa frikë, armiqësi ose rreziqe dhe ku ka tolerancë, drejtësi dhe paqe për të gjithë". Që nga bërja publike e këtij dokumenti, çdo kërkesë e shqiptarëve për zgjidhjen e statusit merrte përgjigje nga ndërkombëtarët se standardet ishin para statusit. Kjo është arsyeja pse në publik edhe njihen më shumë si Standardet para Statusit, ani se titulli i dokumentit, siç shihet, ka qenë i ndryshëm.
Dokumenti **Standardet për Kosovën** përmbante tetë pika:
- themelimi i institucioneve demokratike funksionale;
- ndërtimin e një rendi ku mbretëron sundimi i ligjit;
- promovimi dhe sigurimi i lirisë së lëvizjes;
- kthimet e qëndrueshme dhe të drejtat e bashkësive dhe pjesëtarëve të tyre;
- ekonomia e qëndrueshme;
- të drejtat pronësore të garantuara;
- dialogu ndëretnik dhe ai me Serbinë; dhe, së fundit,
- reformimi **Trupave Mbrojtëse të Kosovës** (TMK).

Në fillim, shqiptarët si popull shumicë, e kuptuan se përmbushja e standardeve ishte e domosdoshme për fillimin e bisedimeve për statusin e Kosovës, por shumë nga standardet ishin të vështira për Kosovën për t'u përmbushur, për disa arsye: e para, sepse vënia e disave prej tyre në jetë kërkonte organe vendore me kompetenca të plota për të vepruar, gjë që nuk e kishin **Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë** (IPVQ) si pasojë e faktit se **UNMIK**-u mbante tërë pushtetin në duart e veta; e dyta, për shkak se serbët, të frikësuar nga rezultati i bisedimeve, sabotonin këto standarde, duke mos marrë pjesë në ndërtimin e institucioneve demokratike të **Kosovës**; e treta, në të njejtën kohë, bashkësia ndërkombëtare pohonte se standardet që kanë të bëjnë komunitetet e **Kosovës** ishin më të rëndësishmet.
Shqiptarët, si popull shumicë, shihnin çdo negocim si diçka formale dhe që duhej kryer vetëm sa për të realizuar një vullnet për dialogim me serbët sepse rezultati përfundimtar duhet të ishte pavarësia e plotë përmes deklarimit të vullnetit të popullit, ashtu siç është premtuar në pikën e tretë të nenit të parë të kapitullit të tetë dhe të fundit të **Marrëveshjes së Rambujesë**.

[102] Kushtetutën e vitit 2008 dhe **Ligjin Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës** i diskutojmë në seksionin në vijim meqë janë dy instrumentet kryesore kushtetuese që përcaktojnë dizjanin aktual kushtetues të Kosovës dhe të gjyqësisë së saj kushtetuese.

[103] *REGULATION NO.1999/1.UNMIK/REG/1999/1.25 July 1999 ON THE AUTHORITY OF THE INTERIM ADMINISTRATION IN KOSOVO.* **Në internet:** http://www.unmikonline.org/regulations/1999/re99_01.pdf (shikuar në dhjetor 2017).

[104] *REGULATION NO. 1999/24.UNMIK/REG/1999/24. 12 December 1999. ON THE LAW APPLICABLE IN KOSOVO.* **Në internet:** http://www.unmikonline.org/regulations/1999/re99_24.pdf (shikuar në dhjetor 2017).

[105] Letter dated 17 November 2004 from the Secretary-General addressed to the President of the Security Council. Report on the situation in Kosovo.*United Nations.*S/2004/932 - Security Council Report. 30 November 2004. Në internet:http://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/ kos %20S2004%20932.pdf

- **Deklarata e Pavarësisë**; dhe
- **Mendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) për Kosovën.**[106]

Rezoluta 1244 është dokumenti i parë i bashkësisë ndërkombëtare me natyrë juridiko-politike që është marrë me organizimin e brendshëm të Kosovës. Ajo ka autorizuar organet e **OKB**-së për themelimin e një misioni civil ndërkombëtar.[107] Për dallim nga **Marrëveshja e Rambujesë,** që asnjëherë nuk hyri në fuqi ashtu siç parashikohej, rezoluta gëzon fuqinë e plotë të një akti juridiko-politik që nxirret sipas **Kapitullit VII** të **Kartës së OKB**-së. Natyrën e vet juridiko-politike e fiton sipas përcaktimit të disa të drejtave dhe detyrimeve për palët në konflikt, shqiptarët dhe serbët, si dhe për vetë bashkësinë ndërkombëtare. Kjo e fundit, bashkësia ndërkombëtare, detyrohej që të siguronte paqen dhe sigurinë për të gjithë, të formojë institucionet vendore të vetëqeverisjes lokale dhe, në fund, të ndërmjetësojë në procesin e gjetjes së një zgjidhjeje politike për statusin përfundimtar të **Kosovës**.

Sa i përket vetëqeverisjes në **Kosovë**, rezoluta konceptualisht nuk ka qenë shumë larg **Marrëveshjes së Rambujesë**, nisur nga fakti se në mënyrë shprehimore theksonte që parimet e saj do të merren parasysh në periudhën transitore të ndërtimit të sistemit të vetëqeverisjes, deri në arritjen e një marrëveshjeje politike në mes të palëve për statusin final.[108] Për një konstitucionalizëm të tipit bashkëkohor, ku supremacia (epërsia) e kushtetutës përbën postulatin thelbësor, as që mund të bëhet fjalë në këtë kohë nga shkaku se **Rezoluta 1244** paraqet manifestim të vullnetit të bashkësisë ndërkombëtare, jo të popullsisë vendore. Ky vullnet i bashkësisë ndërkombëtare, i shprehur përmes **KS** si një organ politik i **OKB**-së, ka parasysh mbrojtjen e vlerave dhe postulateve tjera nga ato që kanë të bëjnë me konstitucionalizmin bashkëkohor. Ato vlera dhe postulate kanë pasur të bëjnë me garantimin e sigurimit të integritetit dhe sovranitetit territorial të RFJ-së, të paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, si dhe ndërtimi i institucioneve të vetëqeverisjes lokale. **Rezoluta 1244** shumë pak flet për promovimin e lirive dhe të drejtave njerëzore.[109]

Në hierarkinë e këtyre vlerave dhe postulateve të sanksionuara me **Rezolutën 1244**, fuqinë më të madhe e kanë dispozitat për sigurimin dhe ruajtjen e integritetit dhe sovranitetit territorial të **RFJ**-së, si një shtet sovran dhe i pavarur. Kjo për shkak se dokumenti i takon KS të **OKB**-së dhe është nxjerrë sipas autorizimeve nga kapitulli VII i **Kartës së OKB**-së.[110] Në këtë kontekst, duhet vërejtur se nuk ka pasur asnjë mundësi që të flitet për sigurimin e supremacisë (epërsisë) së ndonjë dokumenti juridik-kushtetues vendor sepse të tillë nuk ka pasur: ka qenë fuqia e kësaj rezolute që ka qëndruar në maje të teksteve të tjera të natyrës juridiko-kushtetuese të nxjerra nga organet vendore, në cilën do periudhë qoftë në të kaluarën.

Kjo qasje, pra qasja që i jep supremaci (epërsi) një teksti ndërkombëtar, që miratohet nga bashkësia ndërkombëtare apo në emër të saj, në këtë rast nga KS i OKB-së, nuk është e re për Kosovën. Kështu përcaktohej edhe me **Marrëveshjen e Rambujesë.**[111] Në dy këto dokumente vullneti i vendorëve dhe organizimi i brendshëm duhej t'i nënshtroheshin dispozitave dhe urdhrave ndërkombëtare. Organi që siguronte këtë supremaci (epërsi) në dy rastet nuk ishte gjykata vendore, por **KS** si organ politik i **OKB-**së.

---

106 *ACCORDANCE WITH INTERNATIONAL LAW OF THE UNILATERAL DECLARATION OF INDEPENDENCE IN RESPECT OF KOSOVO ADVISORY OPINION OF 22 JULY 2010*. Në internet: http://www.icj-cij.org/files/ case-related/141/141-20100722-ADV-01-00-EN.pdf (shikuar së fundi në janar 2018).

107 Cf. pikat 5-8 dhe 10-11 të Rezolutës 1244.

108 "[…] "**Këshilli i Sigurimit**, **...**
11. Vendos që përgjegjësitë kryesore të pranisë civile ndërkombëtare të përfshijnë:
e) Të ndihmohet një proces politik me qëllim të përcaktimit të statutit të ardhshëm të Kosovës, duke marrë parasysh marrëveshjet e Rambujesë (S/1999/648);
f) Në një fazë përfundimtare, mbikëqyrjen e kalimit të pushtetit nga institucionet e përkohshme të Kosovës tek institucionet e themeluara me marrëveshje politike; […]"

109 Në fakt, **Rezoluta 1244** flet për liritë dhe të drejtat njerëzore vetëm në një vend, në pikën 11 nën "j", ku theksohej se prania civile ndërkombëtare, **UNMIK**-u, do të kujdeset për "mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të njeriut".

110 Cf. paragrafin e dhjetë të Premabulës së **Rezoluitës 1244.**

111 Cf. pikën 6 të nenit të parë të pjesës kuadër të **Marrëveshjes së Rambujesë** që përcaktonte se, në rast mospajtimi, do të vlente Marrëveshja ashtu që palët duhej të harmonizonin të gjitha aktet jurdike dhe veprimet tjera në pajtim me këtë.

Ajo çfarë ngjason me konstitucionalizmin modern, në Kosovë nis me **Marrëveshjen e Rambujesë**, jo me **Rezolutën 1244**. Kjo e fundit, vetëm në një vend bën fjalë për të drejta të njeriut.[112] Vetëm në pastaj, nën autoritetin e **UNMIK**-ut janë nxjerr dokumentet të natyrës juridike që kanë normuar aspekte kushtetuese të lirive dhe të drejtave të njeriut. Në këtë kuptim mund të thuhet se, në aspektin material, dokumentet e **UNMIK**-ut mbi liritë dhe të drejtat e njeriut kanë karakter kushtetues. Ky fakti bën që të njëjtat të ngjasojnë me konstitucionalizmin modern, u mor vesh gjithnjë bëhet fjalë për ngjasim në aspektin e jashtëm normativ.

Ky ngjasim ka të bëjë me rolin dhe vendin e individit në shoqërinë e re kosovare, diçka që ka qenë e reflektuar në secilin prej këtyre dokumenteve ndërkombëtare si më sipër. Ky synim i bashkësisë ndërkombëtare për t'i njohur individit në Kosovë një rol dhe një pozitë krejtësisht të re, shumë më të avancuar dhe më të ndryshme në pikëpamje kualitative në krahasim me çdo fazë tjetër të zhvillimit të **Kosovës,** diskutohet në hollësi në vijim pas diskutimit tonë lidhur me dokumentet bazë me rëndësi kushtetuese të nxjerra nën autoritetin e **OKB**-së në kohën deri te shpallja e pavarësisë së **Kosovës**. Analizën e këtyre e dokumenteve me rëndësi kushtetuese e bëjmë duke u nisur nga rëndësia që ato kanë pasur për organizimin e jetës juridike dhe politike, sociale, ekonomike dhe kulturore në **Kosovë** pas datës 10 qershor 1999. Në këtë bën pjesë edhe analiza e mendimit këshilldhënës për **Kosovën** të **GND**, dokument ky me një rëndësi të madhe për konsolidimin e shtetësisë kosovare në planin ndërkombëtar.

Në këtë mendim, **GJND** ka analizuar në mënyrë jashtëzakonisht të saktë natyrën juridike të dokumenteve të nxjerra nga administrata e përkohshme e **UNMIK-**ut, duke konstatuar se rendi kushtetues i **Kosovës** pas shpalljes së pavarësisë së saj më 17 shkurt 2008, është i ndryshëm nga rendi juridik i krijuar nga bashkësia ndërkombëtare pas datës 10 qershor 1999. Ka edhe një arsye tjetër pse analizojmë këto dokumente në këtë seksion, arsye që ka të bëjë me faktin se në këtë periudhë as që mund të flitet për ndonjë gjyqësi kushtetuese sepse nuk ekziston një tekst burimor kushtetues supremacia (epërsia) e të cilit kundrejt çdo teksti tjetër do të duhej siguruar përmes një mekanizimi institucional të quajtur gjykatë kushtetuese apo gjykatë tjetër e barasvlefshme me te. Kjo supremaci (epërsi) e dokumenteve juridike të bashkësisë ndërkombëtare ndaj çdo akti tjetër juridik ekzistues në **Kosovë** është prezumuar, përkatësisht është marrë si diçka e mirëqenë. Me fjalë të tjera, supremacia (epërsia) e dokumenteve ndërkombëtare në **Kosovë** nga data 10 qershor 1999 është realizuar përmes veprimit të përditshëm rutinor të administratës së **UNMIK**-ut.

Të shohim në vijim se cila ka qenë përmbajtja e këtyre dokumenteve. Përmes kësaj analize lexuesi ynë mund të shohë nga afër evoluimin e të drejtës kushtetuese kosovare nga një e drejtë administrative ndërkombëtare e ushtruar nga burokracia e **UNMIK**-ut në një të drejtë të mirëfilltë kushtetuese të ndërtuar sipas modelit të demokracive kushtetuese liberale të proveniencës perëndimore.

Në kuptim hierarkik, **Rezoluta 1244** paraqet "kushtetutën" e **Kosovës** së pasluftës sepse ka qenë dokumenti me fuqi më të lartë juridiko-politike dhe themel i çdo akti juridik (të përgjithshëm apo individual) të nxjerrë nga **UNMIK**-u deri në shpalljen e pavarësisë më 17 shkurt 2008. Ndër aktet juridike të nxjerra në vijim të zbatimit të zotimeve të Rezolutës, dy kanë rëndësi të veçantë për diskutimin tonë në këtë libër: **Rregullorja Nr. 1991/1** dhe **Rregullorja Nr. 1999/24**. Aktet juridike në formë të rregulloreve kanë paraqitur aktivitetin primar ligjvënës të **PSSP**-së.

Dokumenti i parë i nxjerrë nga **PSPP** në emër të **OKB-**së ka qenë **Rregullorja nr. 1999/1**. Bazat dhe qëllimet për nxjerrjen e kësaj rregulloreje janë dhënë në vetë tekstin e preambulës së saj. Bazat dhe qëllimet që i kanë shërbyer **PSSP**-së si udhëzues me rastin e nxjerrjes së këtij dokumenti kanë qenë dy:

- *e para*, autorizimi të cilin **KS** ia ka bartur Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në bazë të kapitullit të VII të **Kartës së OKB**-së për të formuar, me ndihmën e organizatave relevante ndërkombëtare, një prani civile ndërkombëtare, e njohur si **UNMIK**, me qëllim që adminis-

[112] Cf. fusnotën nr 107 si më sipër.

trata e tillë të vishet me një mandat të përcaktuar me **Rezolutën 1244,**[113] dhe
- *e dyta*, autorizimi që **PSSP** ka marrë sipas **Rezolutës 1244** me qëllim të themelimit dhe mbajtjes së një administrate të përkohshme në **Kosovë.**[114]

Rregullorja ka specifikuar se cili është qëllimi i pushtetit të administratës së përkohshme të OKB-së në Kosovë, kush dhe si e ushtron atë pushtet dhe në emër të kujt. Ky pushtet, sipas kësaj rregulloreje, konsiderohej se ka lindur dhe është krijuar që nga data 10 qershor 1999, datë kur është miratuar **Rezoluta 1244.**[115]

Sipas seksionit 1.1 ["Autoriteti i Administratës së Përkohshme"] të Rregullores krejt autoriteti legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor në Kosovë i takon **UNMIK**-ut dhe ushtrohet nga ana **PSSP**-së. Ky i fundit, sipas pikës 1.2 të seksionit të njëjtë, ka pasur të drejtën e caktimit të çdo personi në çdo pozitë, si dhe largimin e tyre, përfshirë këtu caktimin e gjyqtarëve.

Ushtrimi i këtij autoriteti kaq të madh dhe krejt të pakufizuar në aspektin formal e material nga ana e **PSSP**, megjithatë, ka pasur disa kufij brenda të cilëve është dashur të ushtrohet. Këta kufij brenda të cilëve **PSSP** ka qenë i detyruar të ushtrojë tri pushtetet si më sipër, kanë qenë të përcaktuar me seksionin 3 ["Ligji i Aplikueshëm në Kosovë"] të Rregullores. Sipas kësaj dispozite, si përbërës të ligjit të aplikueshëm në **Kosovë** janë konsideruar:

- aktet juridike që kanë qenë të vlefshme në Kosovë para datës 24 mars 1989. Kjo datë konsiderohet si datë kur **Kosova** ka humbur autonominë e saj legjislative, ekzekutive-administrative dhe gjyqësore që e gëzonte sipas **Kushtetutës së vitit 1974.** Në këto dispozita janë përfshirë të gjitha aktet juridike të nxjerra nga organet kompetente të **Kosovës**, si dhe ato të organeve të **Republikës së Serbisë** dhe të organeve të **RSFJ** në rastet kur për ekzekutimin dhe vënien e tyre në jetë, kanë qenë kompetente dhe të ngarkuara organet e **Kosovës**;
- aktet juridike si më sipër kanë pasur atë vlerë sipas seksionit 2 ["Respektimi i Standardeve të Njohura Ndërkombëtarisht"] të Rregullores, por vetëm me kusht që ato nuk binin ndesh me standardet e njohura ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut dhe nuk ishin diskriminuese mbi bazat si vijon: seksi, raca, ngjyra, gjuha, religjioni, mendimi politik ose mendimit tjetër, origjina nacionale, etnike apo sociale, asocimi me ndonjë komunitet nacional, prona, lindja apo ndonjë status tjetër.

Çështja e supremacisë (epërsisë) së akteve legjislative të **UNMIK**-ut, të cilat kanë pasur formën e rregulloreve, sanksionohej me seksionin 4 ["Rregulloret e Nxjerra nga UNMIK"] të Rregullores. Aty përcaktohej qartë se këto akte me karakter legjislativ kanë mundur të shfuqizohen vetëm përmes nxjerrjes së akteve të natyrës së njëjtë. I vetmi përjashtim nga kjo rregull, i cili parashikohej në këtë seksion, ka pasur të bëjë me aktet që mund t'i nxirrnin në të ardhmen institucionet e themeluara sipas marrëveshjes politike në mes të palëve, **Prishtinës** dhe **Beogradit**, ashtu siç parashihet me **Rezolutën 1244**. Kjo marrëveshje politike, skundër dihet, nuk është arritur meqenëse serbët kanë refuzuar të njohin **Planin Ahtisari** kurse **Kosova**, pikërisht mbi bazën e këtij plani, ka shpallur pavarësinë e saj më datën 17 shkurt 2008. Kjo rrethanë shpjegon se përse në **Kushtetutën e vitit 2008**, në dispozitat që tanimë janë fshirë ngaqë janë tejkaluar me momentin e mbylljes së pavarësisë së mbikëqyrur në shtator të vitit 2012, kanë ekzistuar stipulimet që ua njihnin fuqinë juridike rregulloreve dhe akteve tjera të **UNMIK**-ut deri në zëvendësimin e tyre nga ligjvënësi kosovar.[116] Në fakt, këto dispozita janë futur në Kushtetutë në vijim të zbatimit të **Plani Ahtisari** si pjesë e

---

[113] Sipas **Rezolutës 1244**, prania civile ndërkombëtare ka pasur mandat për të krijuar një qeverisje të qëndrueshme dhe përmbajtësore të **Kosovës** me qëllim që të krijohet një ambient i përshtatshëm për arritjen e një marrëveshjeje politike në mes të palëve dhe transfreimin gradual të kompetencve ndërkombëtare në duart e organeve të themeluara në bazë të marrëveshjes së tillë poltike në mes të palëve me të cilën zgjidhet statusi përfundimtar i **Kosovës**. Cf. pika 11 nën "f" e **Rezolutës 1244**.

[114] Cf. pika 11 prej gërmës "a" deri në germën "d" e **Rezolutës 1244**.

[115] Seksioni 7 ["Hyrja në fuqi"] e Rregullores: "Kjo rregullore konsiderohet se ka hyrë në fuqi më datën 10 qershor 1999, ditën e miratimit të Rezolutës 1244 të KS të OKB (1999)".

[116] Neni 145 ["Vazhdimësia e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe e Legjislacionit të Aplikueshëm"] i Kushtetutës:
"[…] 2. Legjislacioni i aplikueshëm në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute vazhdon të zbatohet për aq sa të jetë në pajtueshmëri me këtë Kushtetutë, derisa të mos shfuqizohet, zëvendësohet ose amendamentohet në pajtueshmëri me këtë Kushtetutë".

detyrimeve të njëanshme që i ka marrë Kosova për shpalljen e pavarësisë së saj dhe njohjen ndërkombëtare nga ana e shumicës së shteteve të botës së sotme.[117]

Dokumenti i dytë i nxjerrë nga **PSSP** në emër të **OKB**-së ka qenë **Rregullorja nr. 1999/24**. Edhe kjo rregullore me rëndësi juridike-kushtetuese konsiderohet se është nxjerrë më datën 10 qershor 1999. Me të, më tutje, janë specifikuar parametrat e ligjit të aplikueshëm në Kosovë: fillimisht afirmohet momenti kohor për ligjin e aplikueshëm në Kosovë, përkatësisht caktohet se i aplikueshëm do të konsiderohet ai ligj që ka qenë në fuqi në **Kosovë** para datës 24 mars 1989, në mënyrë të njëjtë siç përcaktohej me rregulloren paraprake të diskutuar më sipër. Edhe më këtë rregullore parashikohej mundësia që të zbatoheshin dispozitat tjera në fuqi në **Kosovë** pas datës 24 mars 1989, por vetëm me një kusht - që ato dispozita mos të kenë natyrë dhe përmbajtje diskriminuese.

Për dallim nga rregullorja paraprake, kjo në mënyrë më të qartë dhe specifike përcakton parametrat objektivisht të matshëm për standardet ndërkombëtare të zbatueshme në lëmin e lirive dhe të drejtat e njeriut, të cilat çdo autoritet publik apo individ që ushtron funksion publik në Kosovë ishte i detyrueshëm për t'i vënë në jetë. Kjo bëhet e qatë nga redaktimi i seksionit 1.3 ["Ligji i Aplikueshëm"] të Rregullores ku përcaktohej se të gjitha autoritet publike apo individët që ushtrojnë funksione publike detyroheshin të respektojnë standardet ndërkombëtarisht të njohura mbi të drejtat e njeriut, ashtu siç janë reflektuar në mënyrë të veçantë në këto dokumente:

- Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut të datës 10 dhjetor 1948;
- Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut të datës 4 nëntor 1950 dhe Protokollet e saj;
- Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike e datë 16 dhjetor 1966 dhe Protokollet e saj;
- Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore e datës 16 dhjetor 1966;
- Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor e datës 21 dhjetor 1965;
- Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor kundër Grave e datës 17 dhjetor 1979;
- Konventën kundër Torturës dhe Formave tjera të Trajtimit të Shëmtuar, Jonjerëzor dhe Poshtërues e datës 17 dhjetor 1984; dhe
- Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve e datë 20 dhjetor 1989.

Edhe në këtë rregullore sforcohet detyrimi i ndjekjes së politikave jodiskriminiuese në **Kosovë** nga të gjitha autoritetet publike dhe individët që ushtrojnë funksione publike. Kjo shihet nga redaktimi i dispozitës së njëjtë si në rregulloren paraprake, përkatësisht nga redaktimi i dispozitës së seksionit 1.4 të Rregullores, ku thuhej si vijon:

"Asnjë person, që ushtron funksion publik apo mban ndonjë pozitë publike në Kosovë, nuk guxon të diskriminojë asnjë person mbi asnjë bazë, siç janë: gjinia, raca, ngjyra, gjuha, religjioni, bindjet politike ose tjera, prejardhja natyrore, sociale apo etnike, asocimi me ndonjë bashkësi nacionale, prona, lindja apo statusi tjetër […]"

Për dallim nga rregullorja paraprake, kjo rregullore përcakton disa standarde rreth sigurimit të supremacisë (epërsisë) së saj dhe të akteve tjera legjislative të nxjerra nga **UNMIK**-u, përkatësisht nga **PSSP** si i vetmi organ i autorizuar për një gjë të tillë. Seksioni 2 ["Implementimi"] i saj përcaktonte si vijon:

---

[117] Neni 14 ["Aranzhmanet Kalimtare dhe Dispozitat Përfundimtare"] i **Planit Ahtisari**:
"[…] 14.2.1 Rregulloret e UNMIK-ut të shpallura nga ana e PSSP-së, në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244, përfshirë urdhëresat administrative dhe vendimet ekzekutive të nxjerra nga PSSP-ja dhe ligjet e shpallura të miratuara nga Kuvendi i Kosovës do të vazhdojnë së zbatuari, përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, deri në skadimin e vlefshmërisë së tyre, apo deri në anulimin apo zëvendësimin e tyre me legjislacionin që rregullon të njëjtën çështje në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje[…]."

"Gjykatat në Kosovë mund të kërkojnë sqarim nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me implementimin e kësaj rregulloreje. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm do të ofrojë një sqarim të tillë me qëllim që gjykatat ta kenë parasysh gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre".

Nga kjo dispozitë shihet qartë se fjala ka qenë për interpretim të detyrueshëm të dispozitave nga ana e vetë autorit të tyre, **PSSP**-së, me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së të njëjtave kundrejt çdo dispozite tjetër të aplikueshme në Kosovë. Se kjo është kështu bëhet edhe më e qartë nga përmbajtja e dispozitës së seksionit 1.1 ["Ligji i Aplikueshëm"], në të cilën thuhet se rregulloret dhe instrumentet tjera të nxjerra nga **PSSP** gëzojnë supremaci (epërsi) ndaj ligjit që ka qenë i aplikueshëm në Kosovë para datës 24 mars 1989, në rast të konfliktit në mes tyre.

Korniza Kushtetuese paraqet dokumentin më përmbledhës juridiko-kushtetues, i nxjerrë nga UNMIK-u në vijim të zbatimit të detyrës së tij kryesore që e kishte marrë mbi vete konform **Rezolutës 1244**. Ajo detyrë konsistonte në ndërtimin e institucioneve të vetëqeverisjes në vend deri në themelimin e atyre të përhershme që pritej të ndodhte si rezultat e një marrëveshje politike në mes të palëve, diçka që nuk ndodhi asnjëherë. Edhe ky dokument ka formën standarde përmes së cilës **PSSP**-ja ka ushtruar kompetencat e veta sipas **Rezolutës 1244**, përkatësisht formën e rregullores. Kjo rregullore mban numrin **2001/9** dhe është nënshkruar nga **PSSP**-ja më datën 15 maj 2001.

Si në preambulë ashtu edhe në pjesën operative të Kornizës, në syprinë dalin dy qëllime për të cilat është nxjerrë ky dokument me shumë rëndësi për zhvillimin kushtetues të **Kosovës** dhe për historinë e saj bashkëkohore. Si qëllim i parë del organizimi i vetëqeverisjes në **Kosovë** përmes krijimit të **Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes** (**IPVQ),** kurse i dyti konsiston në krijimin e kushteve të duhura për gjetjen e një zgjidhjeje përfundimtare për statusin e ardhshëm të Kosovës.[118]

IPVQ-të në Kosovë kanë mbuluar fushat legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe janë themeluar përmes procedurave demokratike të pjesëmarrjes së popullit të Kosovës në zgjedhjet e lira dhe të drejta. Në këtë kontekst, ndarja e pushtetit ka qenë ndër postulatet themelore të sipas të cilit kanë punuar ato, diçka që po ndodhte për herë të parë në Kosovë, së paku në aspektin formal të kuptimit të ndarjes së pushteteve. Ky proklamim i ndarjes së pushteteve, megjithatë, nuk ka mundur të jetë kuptimplotë: **PSSP**-ja ende ruante kompetencat e veta sipas **Rezolutës 1244** dhe **Rregullores nr. 1999/1** si më sipër, përkatësisht kompetencat legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore në tërë territorin e Kosovës. Kjo reflektohej edhe në tekstin e Kornizës ku flitej për secilën nga këto kompetenca: **PSSP** kishte kompetencë për shpërndarje të kuvendit çdoherë kur vërente se veprimet e legjislativit kosovar binin ndesh me **Rezolutën 1244,**[119] ekzekutivi i Kosovës duhej të vepronte me shumë kujdes sepse fjalën e fundit në çështjet ekzekutive sërish e kishte **PSSP**-ja,[120] dhe, në fund, gjyqësori i **Kosovës** duhej ta kryente punën e vet në bazë të ligjit të aplikueshëm ashtu siç definohej ky term në **Rregullores nr. 1999/24** kurse të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët emëroheshin dhe shkarkoheshin nga vetë **PSSP**-ja.[121]

Këto zgjidhje, si më sipër, janë krejt të natyrshme, nisur nga fakti se supremacia (epërsia) absolute në instancë të fundit i takonte vetëm **Rezolutës 1244**, e cila shërbente si bazë për vlerësimit të ligjshmërisë së gjithë aktivitetin politiko - juridik dhe tjetër në Kosovë. Në kushtet e një administrimi ndërkombëtar, siç ka qenë rasti me **Kosovën**, kontrolli i kushtetutshmërisë do të nënkuptonte sigurimin e supremacisë (epërsisë) së një teksti të brendshëm kushtetues, **Kornizës Kushtetuese**, që kishte autorësi ndërkombëtare dhe shprehte vullnetin ndërkombëtar ngaqë shpallja e saj bëhej në emër të KS të OKB-së nga ana e PSSP. Një situatë e tillë, sikur të ekzistonte teorikisht, do të përbënte një absurd

[118] Cf. Preambulën e **Rregullores nr. 2001/9** dhe Preambulën e **Kornizës Kushtetuese**.

[119] Cf. dispozitën e paragrafit 8.1, germa "b" e kreu 8-të [" Kompetencat dhe përgjegjësitë e rezervuara për PSSP-në"] të **Kornizës Kushtetuese**.

[120] Cf. dispozitën e paragrafit 8.1 nga gërma "c" deri në "dh", si dhe nga gërma "g" deri në "s" të kreut 8-të [" Kompetencat dhe përgjegjësitë e rezervuara për PSSP-në"] të **Kornizës Kushtetuese**.

[121] Cf. dispozitën e paragrafit 8.1, germat "e" dhe "ë"të kreut 8-të [" Kompetencat dhe përgjegjësitë e rezervuara për PSSP-në"] të **Kornizës Kushtetuese**.

dhe një zgjidhje jologjike sipas standardeve dhe parametrave të konstitucionalizmit bashkëkohor. Një kontroll i tillë, thënë me fjalë tjera, do të nënkuptonte të drejtën e Kosovës që përmes një organi të brendshëm të kryente kontrollin e kushtetutshmërisë së vullnetit politik të një organi politik ndërkombëtar që quhet **KS të OKB-**së. Kjo nuk mund të ketë asnjë kuptim sepse organ gjyqësori i **OKB**-së është **GjND** dhe asnjë organ tjetër, në ndërkohë që gjykatat apo organet tjera nacionale në asnjë rrethanë nuk mund të ushtrojnë kontrollin e kushtetutshmërisë së akteve dhe veprimeve të asnjërit prej organeve të **OKB**-së.

Në lëmin e gjyqësisë kushtetuese, përkundër krejt këtyre kufizimeve logjike dhe tërësisht të natyrshme në aspektin juridiko-kushtetues dhe juridiko-ndërkombëtar, Korniza ka ofruar një zgjidhje të çuditshme, unikate dhe krejtësisht kontekstuale e origjinale. Ajo zgjidhje gjendet e ankoruar në stipulimet e pjesës së katërt ["Sistemi Gjyqësor"] të **Kornizës Kushtetuese.** Në seksionin 9.4.11 të kësaj pjese flitej për themelimin e një dhome të veçantë për çështjet e Kornizës në kuadër të **Gjykatës Supreme të Kosovës** (**Dhoma e Kornizës**). Diskutimi i fizionomisë së saj, juridiksionit dhe palëve të autorizuara për vënien në lëvizje është bërë në kuadër të pjesës së Kornizës që bënte fjalë për gjyqësorin kosovar.

Katër lloje të kompetencave të **Dhoma e Kornizës** numërohen në dispozitën si më sipër të Kornizës:

- e para, vendosja lidhur me pajtueshmërinë e ligjeve të **Kuvendit të Kosovës** me **Kornizën Kushtetuese** dhe me instrumentet ndërkombëtare për liritë dhe të drejtat e njeriut të numëruara në kreun 3;
- e dyta, zgjidhja e konfliktit për kompetencë në mes të **IPVQ**-ve;
- e treta, vendosja nëse ndonjë vendim i **IPVQ**-ve mund të cenonte pavarësinë dhe përgjegjësitë e institucioneve dhe organeve të pavarura të parashikuara me **Kornizë Kushtetuese**; dhe, së fundi,
- e katërta, vendosja lidhur me imunitetin e deputetit, anëtarëve të qeverisë dhe kryetarit të **Kosovës**

Si palë të autorizuara, sipas këtij seksioni, mund të paraqiteshin: kryetari i Kosovës, qeveria, pesë deputetë, secili anëtar i kryesisë së **Kuvendit të Kosovës**, komisionet e **Kuvendit të Kosovës**, **Prokuroria Publike** dhe, së fundi, secili organ apo institucion i pavarur i themeluar në bazë të **Kornizës Kushtetuese.**

Sipas Kornizës, si pikë referimi, përkatësisht si parametra për kryerjen e kontrollit kushtetues kanë qenë vetë dispozitat e saj së bashku me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që përmenden në kreun 3 të diskutuar më sipër. Megjithatë, kjo është kështu vetëm në aspektin teorik sepse, sikundër e thamë më sipër, kontrolli real i kushtetutshmërisë nuk ka mundur të ndodhë në kushtet e administrimit ndërkombëtar dhe supremacisë (epërsisë) absolute të **Rezolutës 1244** si shprehje e vullnetit të bashkësisë ndërkombëtare. Kjo është reflektuar në aspektin praktik edhe në vetë dispozitat relevante të Kornizës, të cilat bënin të qartë se Rezoluta dhe pushteti i **PSSP** paraqisnin autoritetin suprem (përfundimtar) dhe të pakontestueshëm në të gjitha sferat e jetës legjislative, ekzekutive, gjyqësore dhe tjetër.[122]

Përkundër arritjeve të bëra gjatë kohës trevjeçare të zbatimit të Kornizës, në veçanti në sferën e zhvillimit të demokracisë parlamentare dhe krijimit të një përvoje të re në ushtrimin e pushtetit, situata e **status quo**-s në **Kosovë** nuk arriti të tejkalohej ashtu që butësisht të niste faza tjetër e realizimit të qëllimit të proklamuar nga hartuesit e saj. Ai qëllim kishte të bënte me krijimin e kushteve për nisjen e bisedave për zgjidhjen përfundimtare të statusit të Kosovës përmes një ndërmjetësimi ndërkombëtar.

[122] Kjo bëhej e qartë jo vetëm nga **Rregullorja nr. 2001/9**, në të cilin gjendej i integruar vetë teksti i **Kornizës Kushtetuese**, por edhe nga preambula dhe pjesët e kryesore operative të kësaj të fundit, siç ishin dispozitat e kreut 12 ["Kompetencat e PSSP"]; Vlen të përmendet se kjo dhomë e veçantë për çështjet e **Kornizës Kushtetuese** asnjëherë nuk është themeluar. Cf. EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION), *OPINION ON HUMAN RIGHTS IN KOSOVO: POSSIBLE ESTABLISHMENT OF REVIEW MECHANISMS.* **Opinion no. 280 / 2004. CDL-AD (2004)033**. Or. Engl. **Strasbourg**, 11 October 2004. Paragrafi:59. Në internet: http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2004)033e (shikuar në mars 2018).

Në fakt, në këtë periudhë u krijua një atmosferë e atillë që çështja e statusit përfundimtar të Kosovës as që mund zihej në goje sepse, në njëfarë mënyre, ajo u shpall si një temë tabu, kurse vetë Korniza nga disa qarqe ndërkombëtare nisi të shihej si një zgjidhje afatgjate. Kjo pati për pasojë nxitjen e një nervoze ndër kosovarët dhe humbjen e durimit dhe shpresës ndër kosovarët. Në të njëjtën kohë u krijua bindja se në Kosovë nuk mund të ketë një perspektivë të mirë dhe të ndritur. Këto dhe çështjet tjera lidhur me situatën në vend gjatë kohës së zbatimit trevjeçar të Kornizës analizohen në një raport tejet të saktë dhe të shkëlqyeshëm të diplomatit norvegjez, **Kai Aide** (Kai Eide).[123]

Raporti **Kai Aide** përbën pikën e kthesës në fazën e përcaktimit të statusit të Kosovës sipas zotimeve të marra me **Rezolutën 1244**. Raporti u bë sipas mandatit të dhënë nga Sekretari i Përgjithshëm i **OKB-së** dhe vinte si rezultat i drejtpërdrejtë i ngjarjeve tragjike të datës 17 dhe 18 mars 2004. Në këto ngjarje humbën jetën 11 shqiptarë, tetë serb, u plagosën më mijëra të tjerë, pjesëtarë të **KFOR**-it, **UNMIK**-ut dhe të **Policisë së Kosovës**, si dhe u shkatërruan e u dogjën me mijëra shtëpi, prona private dhe objekte të trashëgimisë kulturore e fetare të komuniteteve jo shqiptare, kryesisht të komunitetit serb të **Kosovës.**[124]

Në thelb, koha pas hyrjes së trupave të **NATO**-s dhe futjes së **Kosovës** nën administrim ndërkombëtar të **OKB**-së mund të ndahet në dy faza: e para nis më 10 qershor 1999 dhe mbyllet efektivisht me ngjarjet tragjike të 17 dhe 18 marsit 2004, kurse e dyta nis me këto ngjarje dhe mbaron me shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Raporti **Kai Eide** përbën pikën prerëse në mes të këtyre fazave sepse bën vlerësim të saktë të gjendjes në Kosovë në mes të dy periudhave, duke propozuar rrugët që duheshin ndjekur për të ecur tutje në drejtim të zgjidhjes së statusit përfundimtar të **Kosovës.**

Ngjarjet e marsit të vitit 2004 në **Kosovë** erdhën si rezultat i dy rrethanave: e para, ato ndodhën sepse **UNMIK**-u në **Kosovë** nuk kishte asnjë vizion për të ardhmen e vendit duke u fokusuar më shumë në ruajtjen e **status quos**, përkatësisht në vënien në jetë në mënyrë krejtësisht dogmatike vetëm të atyre dispozitave të **Rezolutës 1244** që bëjnë fjalë për integritetin dhe sovranitetin territorial të **RFJ**. Është shumë e vërtete se, nga aspekti i të drejtës ndërkombëtare, **Rezoluta 1244** ka mandatuar **UNMIK**-un që të shërbej në Kosovë si një gardian **bona fide** i integritetit territorial dhe sovranitetit të **RFJ**, i aseteve dhe të drejtave të saj në territorin e Kosovës, i identitetit të saj shtetëror në raport me botën e jashtme dhe kështu me radhë. Kjo gjendje e kujdestarisë, megjithatë, nuk duhej të ishte e pafund dhe pa kushte, për shkak se në atë rezolutë ekziston klauzola e stipuluar në një dispozitë që flet qartë për një zotim të bashkësisë ndërkombëtare për të krijuar kushtet e duhura për të fillim të bisedimeve dhe dialogut në mes të palëve me ndërmjetësim ndërkombëtar për arritjen e një zgjidhje politike të statusit përfundimtar të **Kosovës**. Këtë fakt **UNMIK**-u fare nuk dëshironte ta merrte parasysh si pasojë e ndikimit rus në politikat e **OKB**-së.

Arsyeja e dytë e ngjarjeve të mesit të marsit 2004 ka pasur të bëjë me gjendjen jashtëzakonisht pa perspektivë në Kosovë, ku stagnimi ekonomik dhe paperspektiva zhvillimore dolën në syprinë me tërë ashpërsinë e tyre. Kjo ndodhte sepse **UNMIK**-u insistonte që duhet të shërbejë vetëm si një kujdestar i sovranitetit dhe integritetit territorial të **RFJ**, i aseteve dhe të drejtave të saj në territorin e **Kosovës**, i identitetit të saj shtetëror në raport me botën e jashtme dhe kështu me radhë. Kjo nënkuptonte, sipas UNMIK-ut, që nuk mund të bëhej asnjë transformim pronësor dhe restrukturim i marrëdhënieve të vjetruara ekonomike meqenëse konsideronte se një gjë e tillë nuk ishte në mandatin e tij.

---

[123] **Kai Aide**, në një rikujtim të tij të kohës sa ka punuar për përpilimin e raportit, thekson se para ngjarjeve tragjike të datave 17 dhe 18 mars 2004, statusi i Kosovës as që guxohej të zihej në gojë. Pas këtyre ngjarjeve tragjike, çështja e statusit të u bë një prioritet që kërkonte zgjidhje. Cf. Kai Eide, "Kosovo: the way forward". *NORTH ATLANTIC TREATY ORGANIZATION*. 01 Oct. 2004. Në internet: https:// www.nato. int/ cps/ en/ natohq/ opinions_21120.htm?selectedLocale=en **(**shikuar në dhjetor 2004); Për tekstin integral të raportit në të cilin jepen rekomandimet për nisjen e bisedave për statusin politik të Kosovës si pasojë pamundësisë për të vazhduar me **status quo-**në e vjetër unmikiane si pasojë e ngjarjeve tragjike të marsit 2004, cf. Security Council, *Letter dated 6 August 2004 from the Secretary-General addressed to the President of the Security Council.* S/2004/932. Distr.: General 30 November 2004. Original: English. Në internet: http:// www. securitycouncilreport. org/atf/ cf/%7B 65 BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3CF6E4F F96FF9 %7D /kos% 20S2004 %20932.pdf

[124] Për një përshkrim të detajuar të ngjarjeve tragjike, të humbjeve në njerëz, për dëmet materiale si dhe shkatërrimet e të mirave kulturore të komunitetit serb dhe të komuniteteve tjera joshqiptare të Kosovës, Cf. më shumë në "Failure to Protect: Anti-Minority Violence in Kosovo, March 2004". *HUMAN RIGHTS WATCH* Vol. 16 No. 6 (July 2004). Në internet: https://www.hrë.org/report/2004/07/25/failure-protect/anti-minority-violence-kosovo -march-2004#page (shikuar në dhjetor 2004).

Në ngjarjet tragjike të marsit 2004 vdiqën dhjetëra persona, serbë dhe shqiptarë, u shkatërruan dhe u dogjën me dhjetëra e qindra objekte fetare dhe prona private të qytetarëve të **Kosovës**. **UNMIK**-u dhe autoritetet ndërkombëtare në përgjithësi, përfshirë ato ushtarake, **KFOR**-in, u zunë në befasi dhe pa një vizion e strategji të parandalimit të një gjendje të tillë.[125]

Ky ka qenë sfondi kur më datën 30 korrik 2004, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, **Kofi Anan** (Kofi Annan) emëroi ambasadorin norvegjez, diplomatin e rryer, **Kai Eide**, si personin që do të bënte vlerësimin e tërësishëm të gjendjes në Kosovë, shkaqeve dhe pasojave të ngjarjeve tragjike të mesit të marsit 2004, dhe në fund të jepte rekomandimet e duhura për rrugët që duheshin ndjekur për tejkalimin e gjendjes dhe vënien në jetë të dispozitave të **Rezolutës 1244** lidhur me zotimin ndërkombëtar për të krijuar kushtet për ndërmjetësim ndërmjet palëve me qëllim të gjetjes së një zgjidhjeje politike përfundimtare për statusin e ardhshëm të Kosovës.[126]

Gjendja e krijuar nga ngjarjet e marsit 2004 duhej tejkaluar menjëherë. Ai tejkalim konsistonte në krijimin e një sigurie për serbët lokalë, rindërtimin i shtëpive dhe objekteve të tyre fetare të shkatërruara dhe, së fundi, ndërmarrja e një decentralizimi për nevojat serbëve lokalë, të cilët me shumë vështirësi po e pranonin legjitimitetin e autoriteteve qendrore kosovare, duke i konsideruar ato si të huaja. Këto tri rrethana duheshin adresuar në mënyrë që serbët dhe tjerët të ktheheshin nëpër shtëpitë e tyre. Në të njëjtën kohë, bashkësia ndërkombëtare, sektori i sigurisë që ushtrohej nga ta dhe që kishte dështuar në tërësi për të penguar ngjarjet e marsit, duhej të rikthente besimin tek popullsia lokale për sigurinë që ofrohej nga ta. Shqiptarët, të cilën e kishin humbur shumë besimin në sytë e bashkësisë ndërkombëtare për shkak të organizimit të ngjarjeve tragjike, duhej të punonin shumë për të rikthyer besimin e serbëve lokal dhe të bashkësisë ndërkombëtare në mënyrë që të bindnin këtë të fundit për domosdoshmërinë e nisjes së bisedimeve në mes të palëve, **Prishtinës** dhe **Beogradit**, për të nisur bisedimet për gjetjen e një zgjidhje rreth statusit të ardhshëm të Kosovës. Kjo e fundit ishte e domosdoshme sepse duhej tejkaluar **status quo**-ja e rrezikshme e krijuar të cilën e kishte krijuar udhëheqja e politikave rigjide dhe dogmatike nga ana e **UNMIK**-ut.

Kjo kërkonte përpilim të një strategjie gjithëpërfshirëse dhe të integruar për Kosovën, në mënyrë që të niste dialogu për zgjidhjen e statusit të **Kosovës**. Asnjë moment më nuk mund të pritej dhe të shtyhej më tutje zgjidhja e statusit të **Kosovës**, kishte konstatuar **Kai Aide** në raportin e vet. Në këtë raport ai kishte kërkuar që menjëherë në vjeshtë të vitit 2004 të fillonin diskutimet urgjente rreth çështjes së modaliteteve të përcaktimit të statusit të **Kosovës**. Këto ishin në pika të shkurtra disa nga të gjeturat dhe rekomandimet e raportit të diplomatit **Kai Aide**, i cili i është dorëzuar Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, **Kofi Anan**, më datën 6 tetor 2004 dhe që ka hapur rrugë për mandatimin e një personaliteti tjetër të rëndësishëm për historinë bashkëkohore të Kosovës, ish – presidentit finlandez dhe fituesit të çmimit **Nobel** për paqe në vitin 2008, **Marti Ahtisari** (Marti Ahtisaari), për të ndërmjetësuar në emër të OKB-së në zgjidhjen e statusit të Kosovës. Shumica e të gjeturave dhe rekomandimeve të raportit të **Kaid Aide**-s kanë shërbyer për përpilimin e asaj që më vonë do të njihet si **Plani Ahtisari**, një dokument gjithëpërfshirës juridiko – politik, me karakter kushtetues dhe ndërkombëtar, të cilin serbët e refuzuan, njëjtë siç kishin bërë me **Marrvëeshjen e Rambujesë**. Para se të kalojmë të diskutimi për rrjedhën e përpilimit të Planit Ahtisari, t'i kthehemi sërish periudhës paraprake, disa aspekteve juridiko-kushtetuese, të cilat kanë relevancë për historinë kushtetuese të Kosovës.

Pas ngjarjeve tragjike të marsit 2004, gjendja e të drejtave të njeriut në **Kosovë** u përkeqësua në një shkallë të madhe. Në mesin e shumë arsye për këtë përkeqësim, pa llogaritur këtu dhunën e ushtruar gjatë rrëmujës dhe demonstratave tragjike, kanë qenë ato të natyrës strukturore që kanë të bëjnë me vetë natyrën e administratës ndërkombëtare në Kosovë, **UNMIK-ut** dhe kompetencës së saj ushtarake, **KFOR-it**. Sistemi i instaluar ndërkombëtar, në formë ishte një administrim ndërkombëtar, kurse në përmbajtje funksiononte si një shtet sovran dhe i pavarur. Meqë kjo ishte kështu, atëherë duheshin parashikuar edhe mekanizmat mbrojtës të të drejtave dhe lirive njerëzore, të cilat cenoheshin çdo ditë nga dy komponentët si më sipër të sistemit ndërkombëtar si dhe nga ana e vetë **IPVQ**-ve, të cilat ishin pjesë e strukturave të administrimit ndërkombëtar në Kosovës, bazuar në **Rezolutën**

---

125 Ray Murphy, *UN Peacekeeping in Lebanon, Somalia and Kosovo:Opërational and Legal Issues in Practice* (Cambridge University Press:Cambridge, 2007) fq. 153; Cf. paragarfët 28-29 të Mendimit nr. 280 / 2004 të Komisionit të Venecias (fusnota nr. 122, supra, në këtë skesion).

126 **Security Council**, *Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo.* S/2004/613. Distr.: General 30 July 2004. Original: English. Në internet: http://www.securitycouncil report. org/atf /cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9 %7D/kos %20S2004%20613.pdf

1244. Për t'u arritur diçka në këtë drejtim, **Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës** i dërgoi një letër **Komisionit të Venecias**, përmes së cilës kërkonte që ky komision të bëjë një vlerësim të të metave strukturore dhe të metave tjera të sistemit ndërkombëtar në **Kosovë** dhe të dilte më propozime konkrete për formimin e disa mekanizmave institucionalë, të përkohshëm dhe të përhershëm, me qëllim të përmirësimit të gjendjes së lirive dhe të drejtave në Kosovë.

Pas një analize të gjithanshme të situatës dhe të metave si më sipër që lidheshin me ngjarjet e marsit 2004 si dhe pas dështimit të tërësishëm për të mbrojtur liritë dhe të drejtat e kosovarëve nga ane e UNMIK-ut dhe KFOR-it, Komisioni prodhoi një raport të shkëlqyer ku propozonte themelimin e një **Gjykate për të Drejtat e Njeriut**, me karakter universal dhe të përbërë në shumicë me gjyqtarë ndërkombëtarë.[127] Këta gjyqtarë do të emëroheshin nga **Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës**, kurse njëri nga ta, kryetari, nga ana e kryetarit të **GJEDNJ** apo nga vetë **GJEDNJ** në përbërje të plotë. Juridiksioni i kësaj gjykate parashikohej që të ishte i ngjashëm me atë që ka sot **GJKRKS**, pra mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut të parapara me **KEDNJ** dhe instrumentet tjera kryesore ndërkombëtare, por që përfshinte edhe shkeljet e kryera nga aktet normative të **UNMIKU**-ut, apo rregulloret dhe aktet tjera juridike të nxjerra nga ai. Kjo gjykatë parashihej të kishte autorizimin për anulimin e akteve të tilla juridike. Si palë e paditur mund të paraqitej edhe **KFOR**, kurse si paditës mund të ishin qytetarët, por edhe **Ombudspersoni i Kosovës** që vepronte në kuadër të **UNMIK**-ut.

Kjo nuk u realizua asnjëherë për arsye të ndryshme, në rend të parë financiare dhe politike sepse duhej krijuar juridiksion kundër organizatave ndërkombëtare, siç ishin **OKB**-ja dhe **NATO**, gjë që nuk mund të bëhej për shkak të rezistimit të vendeve anëtarë për një gjë të tillë: pak vullnet politik kanë shtetet për t'iu nënshtruar juridiksionit të huaj nacional apo juridiksionit tjetër në kuadër të një organizate ndërkombëtare ndaj të cilit nuk kanë kontroll.[128] Në vend të kësaj ndodhi formimi i një **Paneli Këshilldhënës**, që po ashtu ishte rekomandim i **Komisionit të Venecias**, si një zgjidhje afatshkurtër për të adresuar gjendjen e keq të të drejtave të njeriut në **Kosovës.**[129] Anëtarët e tij do të caktoheshin nga ana e **PSSP**, me rekomandim të kryetarit të **GJEDNJ**.[130] Ata duhej të ishin juristë të shkëlqyer, në veçanti në lëmin e të drejtave të njeriut në kuadër të sistemit evropian të drejtësisë dhe njerëz me emër të mirë.[131] Kushti i të qenit jurist përbën një shkëndijë të sistemit **kelsenian/evropian** të gjyqësisë kushtetuese kosovare, e cila do të themelohet vetëm më vonë, pas shpalljes së pavarësisë së **Kosovës** dhe krijimit të **GJKRKS.** Ky panel ka ekzistuar deri në vitin 2016, kur ka ndërprerë punën e tij[132]. Në juridiksion të tij kanë qenë cenimet e të drejtave e lirive të njeriut që mund t'i atribuoheshin UNMIK-ut, jo **KFOR**-it.[133] Vendimet e këtij paneli nuk kishin asnjë fuqi detyruese.[134] T'i kthehemi tani çështjes së **Planit Ahtisari** dhe historisë së tij.

---

[127] Për tekstin integral të mendimin të Komisionit, **Mendimit nr. 280/2004**, si dhe elokuencën me të cilën është arsyetuar formimi i një gjykate për të drejtat e njeriut në nëntor të vitit 2004, cf. fusnota 122, **supra**, në këtë seksion.

[128] Ibid., paragrafët 62-66 në. fq. 14-15.

[129] Bazuar në rekomandimet e Komisionit të Venecias si më sipër, me **Rregulloren Nr. 2006/12 mbi Themelimin e Panelit Këshilldhënës për të Drejtat e Njeriut** të datës 23 mars 2006 u bë themelimi i **Paneli Këshilldhënës për të Drejtat e Njeriut**. Për komentet rreth thelemimit, cf. "UNMIK establishes the Human Rights Advisory Panel". Në internet: https://reliefeb.int/report/serbia/unmik-establishes-human-rights-advisory-panel (shikuar në mars 2018).

[130] Cf. Seksioni 5.1 ["Caktimi i Anëtarëve të Panelit"] i **Rregullores Nr. 2006/12.**

[131] Seksioni 4.3 ["Selia dhe Përbërja"] I **Rregullores Nr. 2006/12.**

[132] Për kohën e ndërprerjes së punës së tij, si dhe për raportet mbi punën e tij Cf. në "**Latest HRAP News. 27/06/16". Në internet:** http://www.unmikonline.org/hrap/Eng/Pages/default.aspx **(shikuar në mars 2018).**

[133] Seksioni 1.2 ["Themelimii Panelit Këshilldhënës për të Drejtat e Njeriut"] i **Rregullores Nr. 2006/12:**
"[...] 1.2. Paneli Këshilldhënës ka autorizim për shqyrtimin e kërkesave nga çdo person apo grup individësh që pretendojnë se janë viktimë e cenimeve të të drejtave të njeriut nga ana e UNMIK-ut, ashtu siç parashikohet në njërin nga instrumentet si në vijim:
(a) Deklarata Universale e të drejtave të Njeriut e datës 10 dhjetor 1948
(b) Konventa Evropianë për mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut e datës 4 nëntor 1050 dhe protokollet e saj'
(c) Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike të datës 16 dhjetor 1966 dhe protokollet e saj
(d) Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore të datës 16 dhjetor 1966 dhe protokollet e saj;
(e) Konventën mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial e datës 21 dhjetor 1965;
(f) Konventën mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Gruas e datës 17 dhjetor 1979;
(g) Konventën kundër Torturës dhe Trajtimit a Ndëshkimit tjetër Mizor, Çnjerëzor dhe Poshtërues të datës 17 dhjetor 1984; dhe
(h) Konventa mbi të Drejtat e Fëmijut e datës 20 dhjetor 1989 [...]."

[134] Cf. Seksioni 1.3 ["Themelimi Panelit Këshilldhënës për të Drejtat e Njeriut"] i **Rregullores Nr. 2006/12.**

Marti Ahtisari u caktua në nëntor 2005 si përfaqësues special i **OKB-së** për **Kosovën**, i mandatuar me mision të qartë për të analizuar situatën në terren, për të ndërmjetësuar në mes të palëve dhe, në fund, për të dhënë një propozim lidhur me statusin përfundimtar që Kosova do të duhej ta kishte në të ardhmen. Ky mandat bazohej në **Rezolutën 1244**. Pas shumë bisedimeve dhe negociatave të ndërmjetësuara nga ai dhe ekipi i tij i shkëlqyer,[135] në fillim të vitit 2007, presidenti i **KS** të **OKB**-së e qarkulloi një dokument që përmbante propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Ky dokument që nga kjo kohë u njoh me emrin **Plani Ahtisari**[136] dhe ishte i ndarë nga një letër, të cilën Marti Ahtisari, përmes Sekretarit të Përgjithshëm të **OKB**-së e dërgoi në **KS** të **OKB**-së për miratim. Në letër përmbaheshin rekomandimet konkrete për zgjidhjen përfundimtare të statusit të Kosovës: aty theksohej se pavarësia e mbikëqyrur e Kosovës ishte opsioni i vetëm për zgjidhjen e statusit përfundimtar të Kosovës, duke marrë parasysh historinë violente dhe vuajtjet e popullsisë shumicë nga regjimi i diktatorit **S. Millosheviq**, si kohën e gjatë të administrimit ndërkombëtar të **Kosovës** dhe vetë natyrën specifike të stipulimeve të **Rezolutës 1244**. Këto rrethana e bënin rastin e Kosovës dhe pavarësinë e saj si një rast **sui generis.**[137] Në të njëjtën kohë, **Serbia** dhe delegacioni serb në bisedime gjatë tërë kohës së zhvillimit të tyre në **Vjenë**, mbi 15 muaj përgjatë viteve 2005-2007, qëndroi pasiv, duke besuar se e drejta klasike ndërkombëtare do të mbronte pafundësisht dhe pa asnjë kusht sovranitetit dhe integritetin territorial të **RFJ,** asetet dhe të drejtat e saj në territorin e **Kosovës**, identitetin shtetëror në raport me botën e jashtme dhe kështu me radhë.[138]

Negociatat e drejtpërdrejta, mbi 15 raunde të negociatave të mbajtura vetëm në Vjenë gjatë vitit 2006, u kombinuan me diplomacinë fluturuese të anëtarëve të ekipit të **Marti Ahtisari**t. Kanë qenë ekspertët e ekipit të **Marti Ahtisari** ata që vizitonin dy kryeqytetet e palëve, **Prishtinën** dhe **Beogradin**, në lidhje më çështjet specifike, si dhe për të dhënë ide konkrete për zgjidhje të mundshme kompromisi.[139] Tërë ky proces negocimi me ndërmjetësimin e ekipit të **Marti Ahtisarit** zgjati 15 muaj. Në fund, megjithatë, nuk erdhi deri te kompromisi i pritur sepse **Rusia** vuri veton në draftin e Planit, kurse **Serbia** me këmbëngulje doli kundër tij me propozime për njëfarë autonomie substanciale për **Kosovën,** diçka që nuk u përkrah nga askush përveç aleatit të saj besnik, **Rusisë.**[140]

Serbia insistonte se bisedimet as që kishin nisur dhe se ato duhet të fillonin seriozisht dhe me një format dhe intensitet tjetër, në të njëjtën kohë, duke e denigruar në mediat serbe personalitetin e ndërmjetësuesit **Marti Ahtisari**. Në ndërkohë që **Prishtina** e kishte pranuar me shumë vështirësi Planin dhe koncesionet e tij ndaj serbëve lokalë sa i përket të drejtave të tyre duke nisur edhe procesin e draftimit të kushtetutës së re të Kosovës së pavarur, serbët insistonin për bisedime shtesë. Në një takim të mbajtur në **Gjermani** në **Heiligendamm** më datë 6-8 qershor 2007, presidenti francez të kohës, **Nikola Sarkozi** (Nicolas Sarkozy), propozoi pikërisht një gjë të tillë, bisedime shtesë në mes të palëve, me shpresë së do të gjendej një zgjidhje tjetër që do të pranohej nga dy palët.[141]

---

135 Për detajet e bisedimeve, kohën e zgjatjes së tyre dhe gjendjen e brendshme të palëve dhe të vetë përfaqësuesit special **Marti Ahtisari** dhe ekipit të tij, cf. më shumë në: Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar. Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi* (në kapitullin 12 autori diskuton detajet, si pjesëmarrës në negociata të Vjenës dhe në negociatat tjera shtesë, vështirësitë dhe obstruksuionin serb, kurse në kapitullin 13 autori analizon tekstin e **Planit Ahtisari** nga aspekti politiko - kushtetues dhe juridiko - ndërkombëtar; në kapitullin 14 autori paraqet detaje nga procesi i kushtetutëbërjes në **Kosovë,** gjithnjë në suazat e propozimeve të **Planit Ahtisari** dhe skicës juridiko – kushtetuese të draftuar nga ai, sikundër dhe për rolin e bashkësisë ndërkombëtare dhe ekspertëve vendorë, ka rëndësi të madhe sepse në mënyrë të drejtpërdrejtë ka të bëjë me procesin e draftimit të Kushtetutës së Kosovës sipas rekomandimeve të kuadrit juridik të skicuar në Planin Ahtisari); James Ker-Lindsay, *Kosovo: The Path to Contested Statehood in the Balkans* (I.B.Tauris & Co. Ltd.: London, 2009) (autori në kapitujt 2 dhe 3, nga një këndvështrim tërësisht pro-serb dhe por-rus flet për bisedimet e drejtpërdrejta në **Vjenë** dhe gjetiu me ndërmjetësimin e përfaqësuesit special **Marti Ahtisari** si dhe për propozimet konkrete dhe arsyet e serbëve për mospranim të **Planit Ahtisari).**

136 **Plani Ahtisari** përbëhej prej pjesës kuadër apo pjesës së përgjithshme dhe 12 (dymbëdhjetë ankesave) të kësaj pjese.

137 Në pikën 11 nën "e" të Rezolutës 1244 qartë thuhet se statusi i ardhshëm i Kosovës do të caktohej përmes një procesi politik.

138 Cf. Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar. Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*, fq. 386-390.

139 Cf. Marc Weller, ibid. fq, 327 & 335.

140 Kjo qasje serbe bazohej në paragrafin e dytë të Preambulës së **Kushtetutës së Serbisë**, në fuqi nga shtatori 2006. Aty flitet për të a.q. **autonomi substanciale të Kosovës dhe Metohisë**, shkrehje kjo e përdorur për herë të parë në Marrëveshje e Rambujesë dhe e ripërsëritur në Preambulën e **Rezolutës 1244** dhe në pikën 11 nën "a" të saj. Në esencë, kjo qasje reflekton besimin e verbër serb në dispozitat e të drejtës ndërkombëtare klasike mbi sovranitetin dhe integritetin territorial dhe mbrojtjes së tyre pa kufi dhe pa asnjë kusht. Kjo nuk është kështu sepse secili shtet e ka për detyrim sjelljen e caktuar ndaj qytetarëve të vet dhe jo t'i trajtojë ata në mënyrë të dhunshme dhe si qytetarë të dorës së dytë, siç ka qenë rasti me kosovarët nën regjimin serb.

141 Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar. Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi,* fq. 363.

Një afat i ri 120 ditor u përcaktua për palët: tani Serbia ishte mjaft aktive për dallim nga bisedimet e **Vjenës.**[142] Pala kosovare, ndërkaq, po vazhdonte me punën e vet në përgatitjet për kushtetutën e re dhe modalitetet e implementimit të Planit.[143] Këto bisedime shtesë, të njohura si bisedime me ndërmjetësimin e **Trojkës** (SHBA, BE dhe Rusia) dështuan në fillim të vitit 2008 dhe **Kosova** nuk pati tjetër zgjidhje pos të shpallte pavarësinë e saj më datën 17 shkurt 2008: mbajtja e **status quo**-s të krijuar nga administrimi ndërkombëtar i **UNMIK**-ut ishte bërë i pamundur. Detyrat dhe përgjegjësitë e këtij të fundit i morën përsipër evropianët, misioni **EULEX**, nën udhëheqjen e një përfaqësuesi civil ndërkombëtar, ashtu siç ishte paraparë me aneksin IX ["Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar "] dhe X ["Misioni Evropian për Politika të Sigurisë dhe Mbrojtjes (MEPSM)"] të Planit.[144] Një trup i veçantë qe parashikuar për mbikëqyrjen e punës së këtyre dy organizmave **- Grupi Drejtues Ndërkombëtar** (GDN), i cili duhej të përbëhej nga vendet e Grupit të Kontaktit ku, krahas vendeve perëndimore, hynte edhe Rusia.[145] Këto dy pozicione janë mbajtur nga i njëjti person, diplomati holandez **Piter Fejth** (Pieter Feith:), i cili ka shërbyer në njëfarë mënyre si një mbikëqyrës i përgjithshëm i pavarësisë së mbikëqyrur të Kosovës. Kjo mbikëqyrje e pavarësisë së Kosovës ka mbaruar në shtator të vitit 2012, ani se në dispozitat e Planit nuk qe përcaktuar një datë e saktë se kur do të duhej të ndodhte një gjë e tillë.[146]

Ndër dispozitat më me rëndësi të Planit në lëmin e gjyqësisë kushtetuese janë dispozitat e aneksit I ["Dispozitat Kushtetuese"], si dhe ato që garantonin supremacinë (epërsinë) e tij gjatë tërë kohës së pavarësisë së mbikëqyrur.[147] Në rast mosmarrëveshje lidhur me kuptimin dhe caqet e zbatimit të tij, interpretimi binte në kompetencë ekskluzive të autoriteteve ndërkombëtare, të cilat kanë qenë të autorizuara për të mbikëqyrur pavarësinë e Kosovës.[148]

Edhe **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**, miratuar më 15 prill 2008, përsërit të njëjtat zotime për supremacinë (epërsinë) e dispozitave të Planit. Për më tepër, ajo flet edhe për supremacinë (epërsinë) e dispozitave të rregulloreve dhe akteve të tjera të **UNMIK**-ut deri në nxjerrjen e ligjeve dhe akteve kosovare që do të rregullonin materien e njëjtë

---

142 Ibid., fq. 372.

143 **Kuvendi i Kosovës** me një deklaratë të datës **5 mars 2007** kishte pranuar **Planin Ahtisari** dhe tani mbetej vetëm përgatitja e për vënien e tij në jetë, duke pranuar detyrimet për mbikëqyrjen ndërkombëtare të pavarësisë së shpallur dhe, në të njëjtën kohë, nxjerrjen e kushtetutës së re të **Kosovës**. Marc Weller, fq. 355; Për paraqitjen analitike dhe të detajuar të procesit të draftimit të kushtetutës së re të Kosovës, cf. kapitullin 14 të po këtij libri të Marc Weller ("Hartimi i Kushtetutës së Kosovës dhe dispozitat e posaçme për pakicat në Kosovë").

144 Vetë **OKB** në fillim të vitit 2005 pranonte se shtyrja e zgjidhjes së statusit të Kosovës do të prodhonte jostabilitet edhe më të madh se ngjarjet tragjike të marsit të vitit 2004. Kjo bëri që vitin në vijim të nisin bisedimet, ende pa u plotësuar pritjet nga politika e lansuar e autoriteteve të UNMIK-ut, e njohur si "Standardet para Statusit". Pas përfundimit të negociatave të dorëzimit në KS të OKB-së të **Planit Ahtisari**, për miratim në KS të OKB-së, **Rusia** fuqishëm nisi lobimin për mbajtjen pafundësisht të misionit të UNMIK-ut në Kosvës. Kjo e bëri kalimin e but të autoritetit të UNMIK-ut në misionin e ri të EULEX-it pak më të vështirë. Cf. më shumë për këtë në Oisín Tansey, "Kosovo: Independence and Tutelage. *Journal of Democracy* Vol. 20 No. 2 (2009) fq.153-166 në fq. 159, 160, 165.

145 Neni 4 ["Struktura / Angazhimi i Stafit në Zyrën e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar"] i aneksit IX ["Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar"] të **Planit Ahtisari përcaktonte si vijon:**
"**PCN**-ja do të emërohet nga një **Grup Drejtues Ndërkombëtar** pas konsultimeve me BE-në. **GDN**-ja do ta kërkojë miratimin e **Këshillit të Sigurimit të OKB**-së për këtë emërim. Në **GDN** do të marrin pjesë: **Franca, Gjermania, Italia, Rusia, Britania e Madhe, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian, Komisioni Evropian dhe NATO**-ja".

146 Neni 5 Zvogëlimi dhe Përfundimi i Mandatit të Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar i Aneksit IX ["Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar"] të **Planit Ahtisari**:
"5.1 Bazuar në rekomandimet e **PCN**-së, **Grupi Drejtues Ndërkombëtar** do t'i përcaktojë standardet për shqyrtimin periodik të mandatit të **PCN**-së dhe do ta zhvillojë një shqyrtim të plotë të kompetencave të PCN-së jo më vonë se dy vjet pas hyrjes së fuqi të kësaj marrëveshjeje, duke synuar ngushtimin gradual të fushëveprimit të kompetencave të **PCN**-së dhe shpeshtësisë së intervenimeve të tij / saj.
5.2 Mandati i **PCN**-së do të skadojë atëherë kur Grupi Drejtues Ndërkombëtar të konstatojë se Kosova i ka përmbushur kushtet e kësaj marrëveshjeje".

147 Në nenin 1 ["Dispozitat Themelore"] të Ankesit I ["Dispozitat Themelore"] të **Planit Ahtisari** përcaktohej se **Kushtetuta e Kosovës:**
" 1.1 Do të jetë në të gjitha dispozitat e saj në pajtim me këtë Marrëveshje dhe do të interpretohet në pajtim me këtë Marrëveshje; në rast të mospërputhjeve mes dispozitave të kushtetutës dhe dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, do të mbizotërojnë këto të fundit […]."

148 Neni 11 ["Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar"] i pjesës kuadër apo të përgjithshme të **Planit Ahtisari:**
"[…] 11.3 **PCN** do të ketë përgjegjësi të përgjithshme për mbikëqyrjen, dhe do të jetë autoriteti përfundimtar në **Kosovë** për sa i përket interpretimit të kësaj Marrëveshjeje, siç parashihet me Aneksin IX, e veçanërisht nenin 2, të kësaj Marrëveshjeje […]".

që deri në pavarësi ato e kishin rregulluar.[149] Këto dispozita për supremacinë (epërsinë) e përkohshme të rregulloreve dhe akteve të tjera të **UNMIK**-ut ishte futur në Kushtetutën e **Kosovës** si pasojë e zotimit të njëanshëm të Kosovës për të respektuar **Rezolutën 1244**. Në këto zotime hyjnë edhe zotimet tjera ndërkombëtare që ishin marrë nga **UNMIK**-u në emër dhe për llogari të Kosovës gjatë kohës së administrimit të tij në vend (10 qershor 1999 - 17 shkurt 2008).[150] Kosova e kishte dhënë këtë zotim në mënyrë të qartë në **Deklaratën e Pavarësisë** të datës 17 shkurt 2008.

Në të drejtën ndërkombëtare, çdo deklaratë për shpalljen e pavarësisë paraqet një akt të njëanshëm që krijon detyrime **erga omnes** në të cilat mund të thirret çdokush në bashkësinë ndërkombëtare, secili shtet apo secila organizatë ndërkombëtare.[151] Ka autorë kosovarë që argumentojnë në mënyrë të gabuar se **Kosova** nuk ka përgjegjësi ndërkombëtare sepse nuk është palë në **KEDNJ.**[152] Ky konstatim është i gabuar sepse obligimi ndërkombëtar i Kosovës rrjedh nga **Deklarata e Pavarësisë** dhe zotimi i marrë aty për të vënë në jetë **Planin Ahtisari**, pjesë përbërëse e

---

149 Neni 145. 2 [Vazhdimësia e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe e Legjislacionit të Aplikueshëm] i Kushtetutës:
"[…] 2. Legjislacioni i aplikueshëm në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute vazhdon të zbatohet për aq sa të jetë në pajtueshmëri me këtë Kushtetutë, derisa të mos shfuqizohet, zëvendësohet ose amendamentohet në pajtueshmëri me këtë Kushtetutë."

150 Paragrafi 9 i Deklaratës së Pavarësisë: […] 9. Ne, nëpërmjet kësaj Deklarate, marrim obligimet ndërkombëtare të Kosovës, përfshirë ato të arritura në emrin tonë nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), si dhe obligimet e traktateve dhe obligimet tjera të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ndaj të cilave obligohemi si ish-pjesë konstituive, përfshirë konventat e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike dhe konsullore. Ne do të bashkëpunojmë plotësisht me Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë. Ne synojmë të kërkojmë anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, në të cilat Kosova do të synojë të kontribuojë për qëllime të paqes dhe stabilitetit ndërkombëtar".

151 Paragrafi i fundit i **Deklaratës së Pavarësisë** pa dykuptimësi ngërthen këtë zotim të njëanshëm të Kosovës, kur thotë si vijon:
"[…] 12. Ne, nëpërmjet kësaj, afirmojmë në mënyrë të qartë, specifike dhe të parevokueshme se Kosova do të jetë ligjërisht e obliguar të plotësojë dispozitat e përmbajtura në këtë Deklaratë, përshirë këtu veçanërisht obligimet e saj nga Plani i Ahtisaarit. Në të gjitha këto çështje, ne do të veprojmë në pajtueshmëri në parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, përfshirë Rezolutën 1244 (1999). Ne
"[…] 12. Ne, nëpërmjet kësaj, afirmojmë në mënyrë të qartë, specifike dhe të parevokueshme se Kosova do të jetë ligjërisht e obliguar të plotësojë dispozitat e përmbajtura në këtë Deklaratë, përfshirë këtu veçanërisht obligimet e saj nga Plani i Ahtisaarit. Në të gjitha këto çështje, ne do të veprojmë në pajtueshmëri në parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, përfshirë Rezolutën 1244 (1999). Ne shpallim publikisht se të gjitha shtetet kanë të drejtën të mbështeten në këtë Deklaratë, dhe i bëjmë apel të na ofrojnë përkrahjen dhe mbështetjen e tyre"; Për pikëpamje të ngjashme apo të njëjtë, cf. Colin Warbrick, "Kosovo: The Declaration of Independence" *International and Comparative Law Quarterly*. Volume 57 Issue 03 (July 2008) fq. 675 – 690, në fq. 679 & 684; Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar. Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*, fq. 377.
Në grupin e akteve të njëanshme juridike të cilat prodhojnë efekte juridike dhe detyrime në të drejtën ndërkombëtare, njëjtë si marrëveshjet ndërkombëtare, hyn në kohën më të re edhe **zotimi** (**premtimi**). Ky është një akt i njëanshëm i dhënë në mënyrë publike nga ana e shtetit me të cilin shprehet vullneti shtetëror për vënien në jetë të asaj që premtohet me tekstin e zotimit (**premtimit**). Krahas tij, në literaturë zakonisht numërohen këto akte të njëanshme juridike si burime të së drejtës: notifikimi (lajmërimi), njohja (pranimi), protesta dhe heqja dorë. Këto nganjëherë grupohen në dy grupe, sipas fuqisë së tyre si burime të së drejtës ndërkombëtare. Në grupin e parë hyjnë ato akte të njëanshme me të cilat premtohet diçka, kurse në të dytin hyjnë ato akte juridike të njëanshme të cilat heqet dorë nga një e drejtë subjektive që një shtet e ka.
Kur **zotimi** (**premtimi**) bëhet kundrejt tërë bashkësisë ndërkombëtare, siç ka qenë, ta zëmë, rasti i **Francës** për moskryerjen e testimeve nukleare në **Pacifikun e Jugut** (1974), atëherë të gjitha shtetet kanë të drejtë që të thirren në te për të realizuar një të drejtë apo për të imponuar një detyrim ashtu siç janë premtuar ato në publik. I kësaj natyre është edhe **Deklarata e Pavarësisë** dhe premtimi i bërë aty. Sa i përket vlefshmërisë, për zotimin (premtimin) e dhënë në publik vlejnë të njejtat kushte që vlejnë edhe për marrëveshjet ndërkombëtare: ai nuk duhet të jetë në kundërshtim me normat **jus cogens** të së drejtës ndërkombëtare, nuk guxon të cenojë të drejtat e shteteve të treta, zbatimi i tij duhet të jetë i mundshëm në aspektin material, realizimi i tij duhet të bëhet me mirëbësim (**bona fide**) dhe kështu me radhë. Cf. më shumë për natyrën juridike si dhe për caqet e vlefshmërisë së akteve të njëanshme juridike në të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare, përfshirë zotimin (premtimin) e dhënë në publik, në titujt si vijon: Alfred P. Rubin, "The International Legal Effects of Unilateral Declarations." *American Journal International Law* Vol. 71 No. 1 (January 1977) fq. 1–30; Jean Didier Siçault, "Du caractère obligatoire des engagements unilatéraux en droit international public." *Revue Général de Droit International Public* **83 (1979) fq. 633–688; Jean Charpentier, "Engagements unilatéraux et engagements conventionnels: Différences et convergences." Në Jerzy Makarczyk** *(ed.), Theory of International Law at the Threshold of the 21st Century: Essays in Honour of Krzysztof Skubiszewski* (Kluwer Law International: The Hague, 1996) fq. 367–380; Karl Zemanek, "Unilateral Legal Acts Revisited." Në Karel Wellens *(ed.), International Law: Theory and Practice; Essays in Honour of Eric Suy*. (Martinus Nijhoff: The Hague, 1998) fq. 209–221; Eric Suy, "Unilateral Acts of States as a Source of International Law: Some New Thoughts and Frustrations." Në Olivier Corten, Pierre Klein, Anne Lagerëall, et al., *Droit du pouvoir, pouvoir du droit: Mélanges offerts à Jean Salmon* (Bruylant: Brussels, 2007) fq. 631-642; Vladimir Đuro Degan, *Međunarodno pravo* (Skolska Knjiga: Zagreb, 2011) fq. 192 – 194).

152 Fisnik Korenica & Dren Doli, "Taking Care of Strasbourg: The Status of the European Convention on Human Rights and the Case-Law of the European Court of Human Rights in Kosovo's Domestic Legal System" *Liverpool Law Review* Vol. 32 No. 3 (2011) fq. 209–223.

të cilit janë **KEDNJ** dhe disa instrumente të tjera ndërkombëtare.[153] Ky zotim i njëanshëm i Kosovës bazohej në pranimin nga ana e saj më datën 5 mars 2007 të **Planit Ahtisari** dhe shpalljen e pavarësisë së Kosovës më datën 17 shkurt 2008, pikërisht duke u bazuar në këtë plan. Ky zotim i Kosovës vinte si pasojë e faktit të thjeshtë se draftimi i Deklaratës dhe i vetë Kushtetutës ishte bërë nën kontrollin e rreptë dhe përmes vetë dorës së miqve ndërkombëtarë të Kosovës, në rend të parë SHBA-ve. Miqtë dëshironin që të kompensonin mungesën e përkrahjes nga **KS** të **OKB**-së për pavarësinë e Kosovës, duke detyruar kosovarët që të japin një deklaratë të tillë me të cilën shteti i ri i Kosovës zotohej njëanshëm se do t'i linte dyert e hapura për çdokënd që në të ardhmen dëshironte të thirrej në këto dy dokumente për realizimin e interesave të tyre kundrejt Kosovës. Jo vetëm kaq!

Në vijim, si më sipër, **Deklarata e Pavarësisë** përbën "kushtetutë të parë, historikisht shikuar", ekzistenca e së cilës prezumohet (**Hans Kelsen**), përkatësisht një vendim politik konkret të një populli të ndërmarrë në një kontekst të caktuar territorial dhe kohor (**Karl Shmit**). Në kuptimin modern të teorisë kushtetuese, ajo tregon për një ushtrim të **pouvoir constituant originaire** nga ana e popullit të Kosovës, rrethanë kjo e konstatuar në mënyrë të qartë nga **GJND** në mendimin e saj këshilldhënës, të cilit i kthehemi për diskutim në rreshtat në vijim. Në kontekstin kosovar, me "kushtetutë të parë, historikisht shikuar" nuk nënkuptojmë Kushtetutën e vitit 2008. Një qasje e tillë do të ishte e gabuar. Po ashtu, gabim logjik do të ishte të besohet se **Plani Ahtisari**, meqë asnjëherë nuk ka ndodhur miratimi i tij nga ndonjë organ (vendor apo ndërkombëtar), forcën e vet juridike e nxjerr nga Kushtetuta e vitit 2008.[154]

Plani Ahtisari dhe Kushtetuta e vitit 2008, sa i përket burimit të forcës së tyre juridike, kanë të njëjtën fuqi juridike apo validitet (shprehje e **Hans Kelsen**). Ajo buron nga **Deklarata e Pavarësisë**. Ky dokument paraqet, sikundër u tha, zotim të njëanshëm të shtetit të Kosovës, me efekt **erga omnes**, me qëllim dhe mision të qartë – vënien në jetë të rregullimit kushtetues në Kosovë sipas germës dhe frymës së tij. Sa i përket rendit kushtetues të përkohshëm që ka ekzistuar gjatë periudhës së pavarësisë së mbikëqyrur, nuk ka asnjë dyshim se Plani ka pasur supremaci (epërsi) ndaj Kushtetutës së vitit 2008.[155] Kjo ka të bëjë me hierarkinë e normave në kuptimin kelsenian, ku ekzistimi i normës bazike (**grundnorm**) prezumohet ashtu që çdo interpretim kushtetues duhet të marrë parasysh sistemin e normave në tërësinë e tyre. Supremacia (epërsia) e Planit, në këtë kontekst, për normë bazike ka pasur ekskluzivisht **Deklaratën e Pavarësisë**, në mënyrë të njëjtë siç e ka pasur edhe Kushtetuta e vitit 2008. Kjo ka qenë dhe është rezultat dhe pasojë e rolit dhe pozitës së bashkësisë ndërkombëtare gjatë kushtetutëbërjes në shoqëritë post-konfliktuale. Në fakt, në këto situata, kushtetuta kuptohet si një proces në të cilin realizohen shumë qëllime, jo si një moment apo dokument përfundimtar.[156] Ajo kuptohet si një moment apo dokument përfundimtar vetëm në ato raste kur pushteti konstituiv origjiner realizohet në tërësi brenda kuadrit nacional dhe pa ndërhyrje nga jashtë. Si në situatat kur kushtetuta shihet si një proces, ashtu edhe në ato kur ajo paraqet një moment apo dokument të atypëratyshëm, ekzistimi i normës së saj bazike prezumohet çdoherë.

Ky ekzistim i prezumuar i normës bazike mund të vije, sipas **Hans Kelsen**, si pasojë e një zakoni, revolucioni apo amendamenti kushtetues. Në të gjitha rastet, "kushtetuta e parë, historikisht shikuar" apo **grundnorm** përbën një diçka meta-juridike që supozohet, njëjtë siç supozohet ekzistimi i Zotit. Këtë **grundnormë** të presupozuar, njeriu mund ta njohë dhe interpretojë ekskluzivisht përmes procesit kognitiv sepse ka natyrë meta-juridike, pra jo duke e parë si një akt të vullnetit të krijuesit të parë. Fundja, thotë **Hans Kelsen**, Zoti merret si i mirëqenë (presupozohet) dhe nuk mund të krijohet teoria mbi një tjetër subjekt që urdhëron Zotin: urdhërin e Zotit për të dëgjuar prindërit e marrim si si të mirëqenë, ku si **groundnorm** paraqitet faktori meta-juridik apo Zoti.[157] Të shohim si duket kjo në kontekstin tonë.

---

153 Cf. neni 2.1 ["Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut"] të Planit Ahtisari.

154 Cf. më shumë për këtë qasje kësisoji në Dren Doli / Fisnik Korenica, "What about Kosovo's Constitution: Is there anything special? Discussing the grundnorm, the sovereignty, and the consociational model of democracy." *Vienna Journal on International Constitutional Law* Vol. 5 No.1 (2011) fq. 49-70 në fq. 54-5, 69.

155 Për qëndrim të kundërt që thotë se Kushtetuta e vitit 2008, ka pasur supremaci (epërsi) gjatë kohës së pavarësisë së mbikëqyrur, cf. më shumë në Ibid., fq. 49-70.

156 Emily Hay, "International(ized) Constitutions and Peacebuilding". *Leiden Journal of International Law* Vol. 27 Issue 01 (March 2014) fq. 141-168 në fq. 144-145.

157 Hans Kelsen, *Pure Theory of Law* (The Lawbook Exchange, Ltd.: Clark, New Jersey: 2002, 2009) fq. 193-194; 198-205.

Në kontekstin kosovar, as Plani dhe as Kushtetuta e vitit 2008 nuk përbëjnë "kushtetutë të parë, historikisht shikuar". Është **Deklarata e Pavarësisë** ajo nga e cila burojnë dyja këto dokumente. Kjo është kështu sepse ajo paraqet ushtrim të **pouvoirs constituent originaire të popullit të Kosovës, me efekt të një zotimi ndërkombëtar erga omnes**, përmbajtja e së cilës ngërthen Planin dhe vetë Kushtetutën e vitit 2008. Ndryshe nuk do të kishte asnjë kuptim mendimi i **GJND për Kosovën, i cili në kontekstin kosovar si "kushtetutë të parë, historikisht shikuar" merr Deklaratën e Pavarësisë**, duke mos u mbështetur në Planin Ahtisari, Kushtetutën e vitit 2008, apo në ndonjë akt tjetër derivativ të tyre, siç janë ligjet e detyrueshme për t'u miratuar sipas Planit.[158] **Në këtë kuptim, Hans Kelsen**, konceptualisht nuk dallon shumë nga **Karl Shmit**: dallimi konsiston në arsyetimin e gjenezës së normës së parë. Të dy pranojnë se "kushtetuta e parë, historikisht shikuar" mund të burojë edhe nga revolucioni, por mund të burojë nga një diçka që nuk ka ndërprerje radikale me të kaluarën, ani se **K. Shmit** nuk përdor shprehjen "kushtetutë e parë, historikisht shikuar". Në vend të kësaj, ai me kushtetutë nënkupton vendimin konkret që manifeston një vullnet politik të një populli, kurse me të drejtë kushtetuese nënkupton atë që ne sot e cilësojmë si kushtetutë (të shkruar dhe të pashkruar) dhe që bazohet në një rend apo normë pararendëse.[159] Në këtë kuptim, në renditje hierarkike në kuptimin formal kelsenian dhe shmitian të së drejtës kushtetuese, **Plani Ahtisari** vjen i pari sepse, siç e ka thënë njëri ndër hartuesit efektiv të Kushtetutës së vitit 2008 nga përtej Atlantiku, profesori **Louis Aucoin**, "në fakt, Plani Ahtisari është arsyeja pse u krijua kjo kushtetutë".[160]

Kjo, si më sipër, megjithatë, nuk do të thotë se mungon dallimet thelbësore në mes të **H. Kelsen** dhe **K. Shmit**. Ai dallim lidhet me natyrën e gjenezës së normës së parë: për **H. Kelsen**, "kushtetuta e parë, historikisht shikuar" çdoherë presupozohet, bazuar në logjikën e **Immanuel Kant**-it mbi imperativin kategorik dhe hipotezën metafizike. E thënë ndryshe, "kushtetuta e parë, historikisht shikuar" presupozohet edhe atëherë kur ajo nuk buron nga një vullnet revolucionar origjinal, në mënyrë të njëjtë siç presupozohet ekzistenca e Zotit. Te **K. Shmit**, ndërkaq, "kushtetuta e parë, historikisht shikuar", paraqet shprehje të një akti konkret politik në një moment të dhënë kohor dhe historik me të cilin një popull definon formën dhe përmbajtjen e ekzistencës së vet.[161] **Në këtë kontekst, për H. Kelsen** nuk ekziston një akt konkret politik si moment që e lind një kushtetutë, një "kushtetutë të parë, historikisht shikuar". Kjo është kështu, gjithnjë sipas tij, sepse ai moment prezupozohet që ekziston në po atë mënyrë siç presupozohet ekzistenca e Zotit: çdo fjalë e Zotit përbën një urdhër të padiskutueshëm të cilit i nënshtrohen të gjitha urdhrat tjerë, kurse ekzistenca e dhënësit të urdhrit, Zotit, nuk mund të vihet në pyetje sepse presupozohet ontologjikisht. Për **K.**

---

158 Për ligjet nga Plani Ahtisari, cf. nenin 2 ["Legjislacioni që duhet të miratohet gjatë përiudhës së tranzicionit dhe pas saj"] të Ankesit XII ["Agjenda Legjislative"] të Planit Ahtisari.

159 Carl Schmitt, *Constitutional Theory* (Duke University Press: Durham and London, 2008) fq. 60-61, 67-68, 70-71, 74, 77-80, 82-84, 87-88, 102-103, 107-11, 125, 142, 148.

160 Professor Louis Aucoin, "Views from the Field On Constitution Writing: The Case of Kosovo (Interviwë)". *PRAXIS: The Fletcher Journal of Human Security.* Vol. XXIII (2008) fq. 123-128 në fq. 124.

161 Këto dy kuptime rreth kushtetutës, të cilat, **grosso modo**, sot mund të përmblidhen si kuptime mbi formën dhe natyrën e pushtetit kushtetutëbërës, **pouvoirs constituant**, kanë lindur dhe janë zhvilluar nga **Hans Kelsen** dhe **Karl Shmit** në mes dy luftërave botërore në kontekstin e debatit të tyre mbi gjyqësinë kushtetuese. Këtë e kemi diskutuar në seksionin e dytë të kapitullit të tretë. Ky debat, sikundër dihet, ka pasur të bëj me ekzistencën (**Hans Kelsen**) dhe mosekzistencën (**Karl Shmit**) e nevojës për gjyqësinë kushtetuese si një veprimtari shtetërore juridiksionale që ka për qëllim ruajtjen e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës. Teza e **H. Kelsen** pro kësaj gjyqësie bazohej në faktin se kushtetuta si hierarki e normave, me **grundnorm**-ën në maje të saj, e cila në mund të ketë edhe rrënjë (origjinë) revolucionare, çdo herë presupozohet se ekziston pa marrë parasysh rrënjën (origjinën) e saj (revolucionare apo tjetër). Kjo hierarki e normave, për tu ruajtur, ka nevojë për një organ juridiksional që do të ketë autorizimin ekskluziv për të thënë se çka është në pajtim me kushtetutën e kuptuar si **grundnorm** e çka e kundër me te. Teza e **K. Shmit** kundër gjyqësisë kushtetuese, ndërkaq, bazohej në faktin se kushtetuta përbën një vendim konkret politik të një populli, i shprehur në një moment dhe hapsirë të caktuar, i cili nuk mund të kornizohet pakufi dhe, për pasojë, nuk mudn të ketë një organ juridiksional kushtetues që do ta kufizonte ushtrimin e këtij vullneti konkret politik të popullit në çdo kohë që kjo të shihej e arsyeshme. Ajo që te **H. Kelsen** paraqitet si hierarki e normave, te **K. Shmit** përbën të drejtën kushtetuese, pra jo kushtetutën si akt konkret politik të një populli lidhur me përcaktimin e formës dhe përmbajtjes së shtetit. Për këtë arsye, sipas **K. Shmit**, gardiani i kushtetutës, i kuptuar sipas tij si një akt i shprehjes konkrete të vullnetit politik, mund dhe duhet të kërkohet vetëm në përsonin e shefit të shtetit. Kjo sepse, vetëm shefi i shtetit reflekton këtë vullnet konkret politik, këtë unitet politik popullor. Pikërisht për shkak të kësaj natyre të kushtetutës, e kuptuar si një akt që shpreh vullnetin konkret politik, krijim i një organi juridiksional për mbrojtjen e saj përbën një absurd të llojit të vet, ashtu siç përbën absurd ruajtja e hierarkisë së normave përmes gjyqësisë kushtetuese. Cf. më shumë për këtë në Slobodan Samardzic (ed.), *Norma i odluka. Karl Smit i njegovi kriticari* ("Filip Visnjic": Beograd, 2001); Lars Vinx (ed.), *The Guardian of the Constitution* (Cambridge University Press: 2015) (dy redaktorët japin, në parathëniet e tyre respektive, të gjitha debatet në mes të **Karl Shmit** dhe **Hans Klesen**, ashtu siç janë zhvilluar në origjinë në mes të dy luftërave botërore).

Shmit, ndërkaq, ekziston çdoherë një akt politik konkret origjinal që definon një shoqëri në një moment të caktuar kohor dhe historik, nga i cili akt burojnë normat kushtetuese. Në kohët e sotme, si **H. Kelsen** dhe **grundnorm**, ekzistenca e së cilës presupozohet, ashtu edhe **K. Shmit** dhe vendimi i tij konkret politik i kuptuar si kushtetutë nga ku burojnë normat kushtetuese, bëjnë pjesë në kuptimin e diskutimit mbi **pouvoir constituent**. U mor vesh, ky emërues i përbashkët i kuptimit të kushtetutës te këta dy dijetarë viganë të dijes mbi filozofinë e së drejtës ka kuptim vetëm nëse kemi të bëjmë me **pouvoir constituent originaire** ("kushtetuta e parë, historikisht shikuar", përkatësisht "kushtetuta" si vendim konkret politik). Kjo sepse ky emërues i përbashkët nuk ka asnjë relevancë për **pouvoir constituant** në kuptimin derivativ (kushtetuta si bazë e çdo norme tjetër te **H. Kelsen**, përkatësisht kushtetuta si e drejtë kushtetuese në kuptimin e të drejtës për amendamentim sipas **K. Shmit**).[162] **Këtë dallim, në mënyre të heshtur dhe pa pasur nevojë ta thotë shprehimisht, e ka sqaruar GJND në mendimin e vet për Kosovën: sipas saj, Deklarata e Pavarësisë** nuk buron nga asnjë normë e një rendi tjetër pararendës, por përbën një vendim që shpreh një vullnetit politik konkret të popullit të Kosovës dhe përfaqësuesve të tij, të cilët me shumë të drejtë i ka pagëzuar si **autorët** e Deklaratës.

Në lëmin e gjyqësisë kushtetuese, **Plani Ahtisari** në aneksin e parë flet për dispozitat kushtetuese, të cilat patjetër është dashur të reflektohen në kushtetutën e ardhshme të Kosovës. Në kuadër të këtyre dispozitave, në një mënyrë shumë të qartë ai e radhitë Kosovën në grupin e vendeve me sistem **evropian/kelsenian** të gjyqësisë kushtetuese. Këtë e bën duke ia përcaktuar vetëm fizionominë bazike përmes ndarjes së saj nga gjyqësori i rregullt, pa treguar më hollësisht se cilat do të jenë kompetencat e këtij institucioni kaq me rëndësi për shtetin e ri të Kosovës. E thënë me fjalë të tjera, Plani ka definuar vetëm natyrën e gjyqësisë kushtetuese kosovare përmes tregimit të kompetencave themelore definuese të natyrës **evropiane/kelseniane** të gjyqësisë së ardhshme kushtetuese.

Dy kanë qenë kompetencat që Plani i ka theksuar shprehimisht: e para, kontrolli kushtetues i ligjeve sipas kërkesës së deputetëve kosovarë; dhe, e dyta, kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjera të qeverisë qendrore që kanë të bëjnë me cenimin e përgjegjësisë së komunave apo me zvogëlimin e të hyrave të tyre.[163] Këto dy kompetenca, *e para* klasike kurse *e dyta* bashkëkohore, në këtë dokument janë futur me një porosi të qartë: *e para*, për të siguruar që ligjvënësi kosovar nuk do të abuzonte me vullnetin e shumicën, duke imponuar zgjidhje që shkojnë kundër zotimeve nga **Deklarata e Pavarësisë** dhe vetë Plani; dhe, *e dyta*, duke siguruar që komunat dhe vetëqeverisja lokale në **Kosovë** do të funksiononin sipas standardeve evropiane, jo në një mënyrë të diktuar nga qeveria qendrore. Kjo ka nënkuptuar se akomodimi i interesave të serbëve lokalë duhet të ketë formën e një vetëqeverisje lokale në kuptimin e standardeve evropiane të përcaktuara me **Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale** (1985).

Kjo qasje ka pasur të bëjë ekskluzivisht me serbët lokalë, ani se nga ajo kanë përfituar edhe komunitetet tjera kosovare. Esenca e saj konsiston në atë që të mos lejohet që kjo të marrë formën e një autonomie politiko-territoriale serbe. Kërkesën që vetëqeverisja lokale të ketë natyrë të autonomisë politiko-territoriale, serbët e kishin paraqitur me ngulm gjatë tërë negociatave të **Vjenës** dhe më vonë. Ky insistim serb bëhej me synimin që ata të kishin një autonomi politiko-territoriale, përkatësisht një vendimmarrje kolektive si komunitet për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ta. Me fjalë të tjera, serbët synonin kantonizimin e Kosovës.[164] Këtë kërkesë e kishte refuzuar pala kosovare. Në fund të bisedimeve, ky refuzim u skicua dhe fuqishëm u reflektua në **Planin Ahtisari**, i cili bën

---

[162] Në doktrinë me **pouvoir constituent** nënkutpohen dy lloje: **original dhe derivativ.** I llojit të parë është çdo ushtrim i vullnetit për herë të parë dhe në mënyrë origjiinale me të cilin ushtrim konstituohet shoqëria e organizuar në shtet, jashtë rendit të mëparshëm juridik-kushtetues, kurse e llojit të dytë është çdo ushtrim i pushtetit përmes amendamentimit të një kushtetutese ekzistuese. Cf. më shumë për këtë në Arnaud Le Pillouer, "Pouvoir constituant originaire et pouvoir constituant dérivé: à propos de l'émergence d'une distinction conceptuelle" *Revue d'histoire des facultés de droit et de la science juridique* no. 25-6 (2005-6) fq. 123-141; Martin Loughlin & Neil Walker (eds.), *The Paradox of Constitutionalism. Constituent Power and Constitutional Form* (Oxford University Press: Oxford, 2008).

[163] Në nenin 6 ["Gjykata Kushtetuese dhe Sistemi i Drejtësisë"] të aneksit I të **Planit Ahtisari** parashikohej si vijon:
"[…] 6.2 Dhjetë apo më shumë deputetë të Kuvendit, mes tjerash, do të kenë të drejtën që të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji apo vendimi të miratuar nga Kuvendi para Gjykatës Kushtetuese, si në aspektin përmbajtësor ashtu edhe për procedurës.
6.3 Komunat mund të kontestojnë para Gjykatës Kushtetuese, kushtetutshmërinë e ligjeve apo akteve të qeverisë të cilat cenojnë përgjegjësitë e tyre apo zvogëlojnë të hyrat e tyre […]."

[164] Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar. Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*, fq. 351

fjalë për të drejtat e komuniteteve të Kosovës sipas standardeve evropiane, në veçanti sipas standardeve për të drejtat e minoriteteve nacionale, ashtu siç parashikohet me **Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Nacionale** (1994) të **Këshillit të Evropës** (KE).[165] Serbët, megjithatë, asnjëherë nuk hoqën dorë prej kësaj kërkese për kantonizim të Kosovës. Në bisedimet e mëvonshme të filluara në vitin 2013 në **Bruksel**, pala kosovare bëri një koncesion në këtë drejtim, duke ua njohur serbëve lokalë të drejtën për themelimin e një asociacioni të komunave me shumicë serbe, i cili asociacion, gjykuar sipas **Marrëveshje së Brukselit** të datës 26 gusht 2015, i ka të gjitha veçoritë e një autonomie politiko - territoriale në dobi të serbëve lokal.[166]

Në kohën e parë gjatë pavarësisë së mbikëqyrur dhe disa vite pas saj parashihej një përbërje e përzier e **Gjykatës Kushtetuese**, me gjykatës ndërkombëtarë dhe me gjykatës vendorë, për çka do të flasim në kapitullin dymbëdhjetë të këtij libri. Juridiksioni material i Gjykatës u zgjerua shumë në krahasim me juridisionin e përcaktuar me **Planin Ahtisari**. Në fazën e parë, ky juridiksion material ishte i ndërlidhur dhe kushtëzohej me llojin e pavarësisë që kishte Kosova, një pavarësi e mbikëqyrur ku supremacia (epërsia) e Plani, jo e dispozitave të Kushtetutës së vitit 2008, përbënte esencën e kushtetutshmërisë së asaj periudhe. Në fazën e dytë, pas mbylljes së kësaj pavarësie në shtator të vitit 2012, erdhi deri te shfuqizimi i dispozitave të Planit mbi pavarësinë e mbikëqyrur përmes amendamenteve kushtetuese të nxjerra nga **Kuvendi i Kosovës**, me të cilat i jepej fund pavarësisë së mbikëqyrur dhe kufizimeve të juridiksionit material të Gjykatës Kushtetuese. Tani e tutje, ky organ kishte për detyrë të sigurojë supremacinë (epërsinë) e Kushtetutës së vitit 2008, jo dispozitat e **Planit Ahtisari**. Kjo gjendje, megjithatë, nuk zgjati shumë. Ajo ndryshoi sërish në vitin 2013, në disfavor të Kushtetutës.

Me nxjerrjen amendamentit kushtetues të datës 3 gusht 2015, përkatësisht me nxjerrjen e amendamentit nr. **24** në Kushtetutën e vitit 2008 (tani neni 162 i saj),[167] u krijua baza e re kushtetuese për bartjen e tërësishme jashtë Kosovës të juridiksionit të saj gjyqësor, përfshirë juridiksionin në çështjet kushtetuese. Juridiksionet në fjalë, ai i gjyqësorit të rregullt dhe ai kushtetues, u bartën në të a.q. **Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar, në diskursin publik të njohura si Gjykata Speciale** me seli në Hagë. Pas kontrollit të kushtetutëshmërisë së këtij amendamenti, të kryer nga Gjykata Kushtetuese me aktgjykimin e saj në rastin KO 26/15 të datës 15 prill 2015,[168] dhe hyrjes së tij në fuqi, ka pasuar nxjerrja e legjislacionit implementues, vendor[169] dhe ndërkombëtar,[170] me qëllim të operacionalizimit të **Gjykatës Speciale.** Legjislacioni për krijimin e saj, përfshirë amendamentin kushtetues nr. **24**, janë draftuar në **Bruksel**.[171]

Gjykata Speciale është themeluar si përgjigje ndaj një akuze ndërkombëtare të bërë nga një prokuror zviceran, i njohur si raporti **Dik Marti** (Dick Marty), raport që është përkrahur me një dokument të **Asamblesë Parlamentare (AP) të KE-së,** dokumenti nr. 12462 i datës 7 janar 2011. Këtë dokument

---

165 Ibid., fq. 352.

166 Cf. për analizën juridiko-kushtetuese dhe politike të kësaj marrëveshje, përfshirë këtu analizën e **Aktgjykimit të GJKRKS në rastin KO 130/15**, datë 23 dhjetor 20912, në punimin Enver Hasani, "The case of the Serb Association before the Constitutional Court of Kosovo". Në Andrzej Szmyt and Boguslav Banaszak (eds.), *The Transformation of Law Systems in Central,East European and Southeastern Europe in 1989-2015. Liber Amicorum in Honorem Prof. Dr. DRES. H.C. Rainer Arnold* (Gdansk University Press: Gdansk, 2015) fq. 493-518.

167 **AMENDAMENTIMI I KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, NR. 05 - V – 139 I DATËS 3 GUSHT 2013**. *GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS* / Nr. 20 / 05 gusht 2015, PRISHTINË

168 *AKTGJYKIM në rastin nr. KO 26/ 15. Vleresim i amendamentit të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe referuar më 9 mars 2015 nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, me shkresën nr. 05-433 /DO-318***.** Prishtinë, më 15 prill 2015. Nr. ref.: AGJ 788/15.

169 **Ligji Nr. 05/L-053 PËR DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRËN E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR.** Prishtinë 3 gusht 2015**; DEKRET PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE.** NR. DMN - 003 – 2016. Prishtinë 3 shkurt 2016**.**

170 **Interim Agreement between the Kingdom of the Netherlands and the Republic of Kosovo concerning the Hosting of the Kosovo Relocated Specialist Judicial Institution in the Netherlands**. Pristina, 26 January 2016.

171 Fisnik Korenica, Argjend Zhubi, Dren Doli, "The EU-engineered hybrid and international specialist court in Kosovo: How 'special' is it?, fq. 474–498 në fq. 479.

më pastaj **Kosova** e ka kthyer në një detyrim ndërkombëtar që duhet të zbatohet përmes ratifikimit të tij në **Kuvendin e Kosovës** më datën 23 prill 2014.[172] Për këtë do të flasim më shumë në kapitullin në vijim kur të prekim çështjet e juridiksionit të **GJKRKS** në të kaluarën dhe aktualisht, në tërë hollësinë e tyre.

Deri këtu shtjelluam dokumentet bazë të shtetësisë së Kosovës - **Planin Ahtisari** dhe **Deklaratën e Pavarësisë**. Në kapitujt në vijim diskutojmë **Kushtetutën e vitit 2008**, historinë e draftimit të saj në pika të shkurtra dhe dizajnin kushtetues të instaluar nga ajo. Në seksionin që flet për këto dy aspekte të kushtetutës, ndalojmë shkurtimisht tek aspektet që kanë të bëjnë me gjyqësinë kushtetuese, e cila është temë bosht e këtij libri. Për momentin, koha është t'i kthehemi në pika të shkurtra një dokumenti shumë më rëndësi për **Shtetin e Kosovës** dhe ardhmërinë e tij. E kemi fjalën për mendimin këshilldhënës të **GJND** lidhur me deklaratën e **Kosovës** për shpalljen e njëanshme të pavarësisë. Rëndësia e këtij dokumenti duhet parë në disa aspekte. Në rend të parë, ai nuk duhet të shihet nga këndi i gabuar që dëgjohet nganjëherë, sipas të cilët ky mendim konfirmon që **Kosova** ndërkombëtarisht gëzon të drejtën e secesionit, përkatësisht të drejtën për vetëvendosjen e jashtme. Këto dy çështje, **secesioni** dhe **vetëvendosja**, fare nuk kanë qenë objekt i mendimit në fjalë të **GJND**. Në mënyrë paradoksale, një qasje të tillë e ka pasur edhe vetë **Serbia**, pra qasjen që e bën objekt të mendimit përgjigjen në pyetjen nëse **Kosova** dhe populli i saj gëzojnë të drejtën për secesion si njëren ndër format kryesore të manifestimit të së drejtës për vetëvendosje të jashtme (e drejta për pavarësi dhe sovranitet të plotë). Kështu, në esencë, pat qenë përmbajtja e pyetjes dhe insistimi fillestar i **Serbisë** i shprehur në letrën/ kërkesën e saj drejtuar **Asamblesë së Përgjithshme (AP) të OKB**-së. Me fjalë të tjera, me këtë letër/kërkesë, ajo insistonte që **AP** të kërkojë një mendim këshilldhënës nga **GJND** lidhur me atë nëse **Kosova** kishte të drejtën e secesionit, si njëra prej formave standarde të realizimit të vetëvendosjes së jashtme (e drejta për sovranitet dhe pavarësi të plotë). **GJND,** megjithatë, kishte shfrytëzuar të drejtën e saj ligjore që ia njeh **Statuti i GJND**-së, për riformulim të secilës pyetje të parashtruar nga palët me qëllim të dhënies së një përgjigjeje sipas parametrave profesional mbi juridiksionin e saj të përcaktuar me **Statutin e GJND** dhe nga praktika e mëhershme.[173]

Aspekti i parë që manifeston rëndësinë kolosale të këtij mendimi ka të bëjë me faktin se një organ gjyqësor i bashkësisë ndërkombëtare, **GJND**, ka konfirmuar se **Deklarata e Pavarësisë** nuk ka shkel as të drejtën e përgjithshme e as të drejtën e posaçme ndërkombëtare. Ajo nuk cenon të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare sepse kjo e drejtë ka një qëndrim neutral ndaj lindjes dhe zhdukjes së shteteve, përveç rasteve kur ato lindin ose zhduken si pasojë e përdorimit të dhunës në mënyrë jo të ligjshme ndërkombëtarisht apo kur lindja dhe zhdukja e shteteve bazohet në cenimin e rregullave mbi gjenocidin, apartheidin dhe rregullat tjera të natyrës **jus cogens** në të drejtën ndërkombëtare. Në rastin e Kosovës nuk ka qenë rasti me asnjërën prej këtyre situatave kur u lind si shtet më datën 17 shkurt 2008. Sikur mendimi të kishte thënë të kundërtën, një gjë e tillë do ta kishte bërë jashtëzakonisht të vështirë mbijetesën e **Shtetit të Kosovës**. Mbase mund të thuhet se një mendim i kundërt me këtë që është dhënë do t'i hapte rrugë zhbërjes së **Kosovës** si shtet sovran dhe i pavarur sipas të drejtës ndërkombëtare.

Autorë të njohur të së drejtës ndërkombëtare, me shumë skepticizëm e kanë parë shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Ani se e kanë cilësuar si një akt të njëanshëm me efekt **erga omnes**, në thelb ata

---

[172] **LIGJI NR. 04/L -274 PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE NË MES TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE BASHKIMIT EVROPIAN MBI MISIONIN E BASHKIMIT EVROPIAN PËR SUNDIM TË LIGJIT NË KOSOVË.** *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* nr. 32/14. Datë 15 maj 2014.

[173] **Serbia,** si sponsorizuese e vetme e Rezolutës 63/3 të datës 8 tetor 2008, me letrën e saj të datës 22 gusht 2008 kërkonte nga **AP e OKB-së** që kjo kërkonte një mendim këshilldhënës nga **GjND** lidhur me atë nëse "deklarata e shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës ishte në pajtim me të drejtën ndërkombëtare". Si autorë të deklaratës së njëanshme të pavarësisë, Serbia i prezumonte **IPVQ**-të e **Kosovës**. GjND, ndërkaq, duke përdorur të drejtën e riformulimit të pyetjes kishte vënë në spikamë autorësinë tjetërfare të autorëve të deklaratës së njëanshme për pavarësinë e Kosovës: **GJND** bëri dallim në mes të **IPVQ**-ve dhe autorëve të deklaratës së njëanshme për pavarësinë e Kosovës. Ky dallim theksonte se ata që kishin shpallur deklaratën e njëanshme për pavarësinë e **Kosovës,** nuk kishin vepruar si **IPVQ,** por si përfaqësues të sovranit të **Kosovës,** duke krijuar kështu një rend tjetër juridik dhe kushtetutës, të ndryshëm nga ai i instaluar përmes **Rezolutës 1244**. Cf. në veçanti paragrafi 49-56 ["Caqet dhe Kuptimi i Pyetjes"] të **Mendimit të GjND për Kosovën**.

kanë insistuar se faktet në terren në momentin e shpalljes së pavarësisë dhe pas saj nuk flasin për ekzistimin e një shteti, por për përpjekje për krijim të një shteti të ri në territorin e një shteti tjetër sovran, Republikës së Serbisë.[174]

Aspekti i dytë që manifeston rëndësinë kolosale të këtij vendimi, ka të bëjë me faktin se organi gjyqësor i bashkësisë ndërkombëtare, **GJND**, konfirmoi se Deklarata e Pavarësisë ishte bërë duke mos u mbështetur në rendin juridik të krijuar me **Rezolutën 1244**, por në vullnetin sovran të popullit të Kosovës. Thënë me fjalë të tjera, mendimi i **GJND** konfirmoi se rendi juridik që u krijua me këtë dokument të **Kosovës** paraqet një rend origjiner juridik që ekziston jashtë rendit të krijuar nga autoritetet e **UNMIK**-ut.[175] Mendimi nuk e thotë në mënyrë shprehimore, mirëpo ai në këtë pjesë në mënyrë të qartë diskuton doktrinën mbi **pouvoir constituant originaire**, përkatësisht mbi pushtetin origjiner konstitutiv të popullit që asnjëherë dhe në asnjë rrethanë nuk konsumohet, përkatësisht mund të ushtrohet çdoherë. Ky pushtet, siç e shpjegon **K. Shmit**, në çdo rast kur ushtrohet ka forcën e një vendimi konkret të tërë një populli të caktuar lidhur me definimin (përcaktimin) e fatit të vet politik.[176] Si i tillë, vendimi konkret i përfaqësuesve të popullit të Kosovës i shprehur më datën 17 shkurt 2008, nuk mund të injorohej e aq më pak të zhbëhej: tani e tutje ngelej në vullnetin sovran të shteteve të tjera për të njohur ose jo këtë vullnet të kosovarëve të shprehur kësisoj dhe në një mënyrë demokratike.

Këto aspekte si më sipër patën një rëndësi të madhe për konsolidimin e shtetësisë së Kosovës, me gjithë gabimet e mëpastajme të lidershipit të **Kosovës** që nisi një dialog me **Serbinë**, pa kokë e krye, siç thotë populli, duke ua hapur gojën e atyre që në fillimin kishin hezituar për ta njohur pavarësinë e **Kosovës**, që në një mënyrë të heshtur të ndërrojnë mendimin dhe qasjen e tyre ndaj **Kosovës**. Pa një strategji për bisedime dhe pa një ide se ku synohej të dilet në fund të tyre dhe pa asnjë levë ndikimi nga pala kosovare ndaj rezultatit përfundimtar të bisedave që nisën në vitin 2013 në **Bruksel,** bënë që konsolidimi i shtetësisë së **Kosovës** të ngecë dukshëm. Kjo hetohet lehtë nga rënia progresive dhe në mënyrë graduale e numrit të njohjeve pas vitit 2013.

Mendimi i **GjND** nuk ngeli pa vërejtur dhe pa i hyrë në punë gardianit të Kushtetutës së Kosovës në luftën e saj, sipas rregullave të profesionit, për të zënë hapësirën e akterëve ndërkombëtarë, të cilët, duke u bazuar në **Planin Ahtisari**, ende ishin pjesë përbërëse e pavarësisë së mbikëqyrur dhe ushtronin ligjërisht disa nga funksionet që do të duhej t'i ushtronte gjyqësori vendor. Ndër to bënin pjesë edhe një pjesë e caktuar e kompetencave të **Gjykatës Supreme të Kosovës**, seksioni i saj që gjykonte lidhur me çështjet rreth privatizimit në **Kosovë**. Në aspektin formal, ky seksion operonte, bazuar në **Planin Ahtisari**, brenda instancës më të lartë gjyqësore në **Kosovë**. Sjelljet e këtij seksioni, megjithatë, ngjanin shumë me uzurpim të pushtetit sepse dukshëm tejkalonin mandatin e dhënë sipas Planit, këtij dokumenti mbi bazën e të cilit **Kosova** kishte shpallur pavarësinë. Vlen të përsëritet se Plani ka pasur për qëllim kryesor avancimin, asnjëherë pengimin, e pavarësisë së Kosovës dhe sovranizimin e saj sa më shpejt e fuqishëm në planin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

Në vazhdim si më sipër, në vijim diskutojmë një aktgjykim të **Gjykatës Kushtetuese**, i njohur si rasti i **Agjensionit Kosovar të Privatizimit (AKP**), në të cilin u përdor mendimi i **GjND**-së për Kosovën si bazë për vendimmarrje.

---

[174] Colin Warbrick, "Kosovo: The Declaration of Independence", fq. 675 – 690 (shkrimi i këtij autori përshkohet në tërësi me një skepticizëm sa i përket **Shtetit të Kosovës**; autori thot se **Deklarata e Pavarësisë** përbën një akt të jashtëzakonshëm me efekte **erga omnes**, i cili nuk krijon precedent sepse përbën vetëm një praktikë të rrallë; bile autori e quan anomali dhe rast special, sepse para aktit të shpalljes dhe fill pas tij fare nuk ka pasur shtet; **Deklarata e Pavarësisë** është e jashtëzakonshme sepse krijon detyrim duke përqafuar në tërësi letrën, frymën dhe shpirtin e **Planit Ahtisari**, detyrim ky që kryesisht ka të bëj me mbrojtjen e minoriteteve kosovare; mirëpo, sipas autorit, Kosovës i mungojnë elementet tjera të shtetësisë, siç është ushtrimi i pushtetit sovran në mënyrë të pavarur, si një element kryesor, i cili ushtrohet nga ndërkombëtarët; nëse Kosova do të cilësohet si një shtet sovran dhe i pavarur, faktet duhet të krijohen; për momentin ky nuk është rasti; nuk ka fakte për shtetësinë e Kosovës pas shpalljes së pavarësisë, konstaton në fund autori).

[175] Cf. Paragrafet 101-121 të **Mendimit të GJND për Kosovën**.

[176] Më shumë në lidhje me këtë në Carl Schmitt, *Political Theology; Four Chapters on the Concept of Sovereignty* (The University of Chicago Press: Chicago, 2005) pp. 16-35; Slobodan Samardzic (ed), *Norma i Olduka: Karl Smit i Njegovi Kriticari*, fq. 85-124.

Rasti i **AKP-së** në aspektin formal ka të bëjë me shqyrtimin kushtetues të një vendimi të **Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës**, vendimit ASC -09-089 të 4 shkurtit 2010.[177] Parashtruesi i kërkesës u ankua, duke pretenduar se vendimi në fjalë, që ishte objekt primar i vlerësimit të kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese, kishte shkelur në mënyrë specifike nenet 3.2 ["Barazia para Ligjit"], 31.2 &3 ["E Drejta për Gjykim të Drejtë e të Paanshëm"], 54 ["Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave"], 102.1 & 4 ["Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor"], 112.2 ["Parimet e Përgjithshme"], 116.3 ["Efekti Juridik i Vendimeve"], 143 ["Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës], 145.2 ["Vazhdimësia e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe Legjislacionit të Aplikueshëm"] të Kushtetutës si dhe nenin 13 ["E Drejta për Mjete Efektive"] të **KEDNJ.**

Esenca e **petitumit** të kësaj ankese kushtetuese del në sipërfaqe vetëm nga përmbajtja e vendimit të sipër cekur të Dhomës, i cili edhe ka qenë objekt i kontrollit të drejtpërdrejtë kushtetues. Në verdiktin që ngërthehet në këtë vendim, Dhoma kishte konstatuar se **AKP** nuk asgjë pos një agjenci **de facto** e **Kosovës** që vepron sipas një ligji po ashtu **de facto**. Ky ligj, gjithnjë sipas saj, nuk mund të kishte asnjë tjetër vlerë juridike pos vlerës së një rregulloreje të brendshme të **AKP**-së, e cila, në anën tjetër, nuk ishte pos një trup **de facto** i një sistemi juridik-kushtetues "të egër", të cilin dhoma nuk e njihte si të vlefshëm sepse bazohej në Kushtetutën e vitit 2008. Ky qëndrim, thënë ndryshe, konstatonte se nuk ekzistonte një ligj i vërtetë i një parlamenti të vërtetë të një vendi sovran dhe i pavarur. Në mënyrë efektive, ky qëndrim tërthorazi mohonte se **Kosova** kishte një organ me kompetencë parësore për nxjerrjen e ligjeve që reflektojnë vullnetin e sovranit, pra një parlament kosovar. Si pasojë e kësaj logjike, një qasje e tillë më tutje nënkuptonte se asnjëherë nuk kishte pasur bazë ligjore për themelimin e një agjensioni tjetër të vlefshëm për udhëheqjen e procesit të privatizimit në **Kosovë, AKP**-së, e cila, si e tillë, duhej të zëvendësonte ligjërisht institucionin **Agjensionit Kombëtar të Mirëbesimit (AKM)**, i cili deri te nxjerrja e këtij ligji ka pasur rolin udhëheqës në procesin e privatizimit në **Kosovë**.

Ky organ i ri kosovar, **AKM**, sipas qasjes së Dhomës, nuk mund të ishte asgjë tjetër pos një entitet **de facto**, përkatësisht "i egër".[178] Ky qëndrim i përgjithshëm i saj, që njihte si bazë të punës së vet vetëm infrastrukturën kushtetuese dhe ligjore të ndërtuar nga administrata e **UNMIK**-ut, prekte esencën e ***pouvoir constituant originaire,*** pushteti konstitutiv origjinal, të cilin **Kosova** e kishte fituar përmes shprehjes së vullnetit konkret politik të sovranit të vet më datën 17 shkurt 2008, ditën kur u shpall pavarësia. Përveç kësaj, ky qëndrim prekte edhe legjitimitetin dhe legalitetin e ushtrimit të autoritetit publik nga ana e autoriteteve kosovare, të cilat u themeluan në mënyrë të rregullt dhe ligjërisht të duhur pas shpalljes së pavarësisë. Thënë ndryshe, përveç pushtetit konstitutiv, qëndrimi i Dhomës prekte edhe thelbin e **pouvoir constitué,** të pushtetit që buronte nga Kushtetuta dhe ligjet e sovranit të ri të Kosovës dhe që ushtrohej nga organet, institucionet dhe individët e këtij sovrani. Në mesin e tyre bënte pjesë edhe institucioni i **AKP-**së, i krijuar si një ndër **pouvoir constitué** të Kosovës sovrane dhe të pavarur me qëllim të zëvendësimit të **AKM**-së së **UNMIK**-ut në sferën e udhëheqjes së procesit të privatizimit. Ky zëvendësim ishte bërë në pajtim me zotimin e njëanshëm të Kosovës, të marrë përmes **Deklaratës së Pavarësisë** dhe që ishte reflektuar në nenin 154.2 të Kushtetutës së vitit 2008 të diskutuar më sipër.

Ky qëndrim i përgjithshëm i Dhomës ka nevojë për një qartësim të mëtejmë për lexuesit tanë lidhur me çështjet si vijon: çka është Dhoma? Cili ka qenë autoriteti i saj? Çka është **AKP** dhe cili është ligji sipas të cilit ajo vepron brenda rendit kushtetues-juridik të Kosovës sovrane dhe të pavarur? Çka ka qenë **AKM**? Cili ka qenë statusi i **AKM-**së brenda rendit juridik të krijuar nga **UNMIK**-u pas qershorit të vitit 1999?

Procesi i privatizimit në **Kosovë** që filloi menjëherë pas instalimit të administratës së **UNMIK**-ut në qershor të vitit 1999, ka pasur specifikat e veta. Në fakt, çdo proces i privatizimit pas kolapsit

---

[177] *Aktgjykimi në rastin nr. KI 25/10 i datës 31 mars 2011. Parashtruesi i kërkesës: Agjencia Kosovare e Privatizimit. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC 09—89, të 4 shkurtit 2010.*

[178] **Ligji Nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit i datës 21 maj 2008.** *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* nr. 30/2008. Datë 15 qershor 2008.

të komunizmit më 1989, ka qenë specifik dhe ka reflektuar specifikat nacionale në varësi të karakteristikave të secilit shtet.[179] Në këtë drejtim, **Kosova** nuk bën përjashtim. Specifikat e Kosovës konsistojnë, **inter alia**, në faktin që i tërë procesi i privatizimit ka qenë i udhëhequr nga **UNMIK**-u përmes **AKM**-së, përderisa organet dhe autoritetet vendore shërbenin si autoritete jo vendimmarrëse. Prezenca e tyre në atë proces, në thelb, ishte sa për sy e faqe.[180] Baza juridike për këtë lloj privatizimi, i cili nisi pas qershorit 1999, gjendej në një rregullore të **UNMIKU**-t, **Rregulloren Nr. 2002/12.**[181] Sipas kësaj rregulloreje, **AKM** ka shërbyer si një institucion përgjegjës për udhëheqjen e tërë procesit të privatizimit në Kosovë, kurse dhoma si një organ me kompetencë për të gjykuar dhe vendosur lidhur me të gjitha çështjet që kishin të bënin me privatizimin.[182]

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, bazuar në autorizimet e reja si **pouvoir constitué**, të cilat i njohin një shteti të ri sovran dhe të pavarur të drejtën për të themeluar organe e institucione kushtetuese dhe ligjore, Kuvendi, më datën 21 maj 2008, nxori **Ligjin nr. 03/L-067**.[183] Me këtë supozohej se **Rregullorja për AKM**-në do të shfuqizohej në ditën e hyrjes në fuqi të **Ligjit për AKM-**në. Një gjë të tillë e parashikonte vetë ky i fundit por edhe Kushtetuta e vitit 2008. Kjo sepse Ligji për AKM-në tani e tutje ishte ligji që rregullonte veprimtarinë, të drejtat dhe detyrimet e organit të ri që do të udhëhiqte punët e privatizimit në Kosovës. Ky organ tani do të quhej **AKP**, jo **AKM** si dikur para pavarësisë së Kosovës. Me fjalë tjera, **Ligji për AKM** shfuqizonte **Rregulloren për AKM**-në në sferën udhëheqjes dhe vendimmarrjes në procesin e privatizimit, duke transformuar në mënyrë radikale juridiksionin në çështjet e privatizimit në të gjitha shkallët.

Kuvendi i Kosovës pas pavarësimit pati nxjerrë një ligj tjetër me të cilin rregulloheshin në mënyrë të re juridiksioni, mënyra e përzgjedhjes së rasteve, si dhe mënyra e zgjedhjes së prokurorëve e gjyqtarëve të misionit **EULEX**-it.[184] Ky mision kishte nisur punën si pjesë e pavarësisë së mbikëqyrur të Kosovës me të vetmin qëllim ndihmën në promovimin e sundimit të ligjit. Dhoma ishte pjesë e këtij misioni. Përmes këtij ligji synohej që të bëhej integrimi dhe unifikimi i kompetencave, gjyqtarëve e prokurorëve të **EULEX**-it në Kosovë, përfshirë dhomën si më sipër. Përkundër kësaj qartësie në qëllimin primar të këtij ligji, dhoma u bë burim i keqkuptimeve për shkak të interpretimeve të gabuara të të drejtave dhe detyrave të saj kushtetuese dhe ligjore pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Në vend se të shfrytëzonte këtë ligj si bazë për të tejkaluar dallimet në mes të gjyqtarëve dhe prokurorëve kosovarë dhe kolegëve të tyre të **EULEX**-it, dhoma, në bazë të qëndrimeve të veta arbitrare dhe uzurpuese, të shprehura në vendimin e saj ASC -09-089 të 4 shkurtit 2010 që ishte objekt i kontrollit kushtetues në Gjykatën Kushtetuese, ia mohoi **AKP**-së statusin ligjor në çështjet e privatizimit duke vazhduar në të njëjtën kohë me trajtimin e **AKM**-së si të vetmin përfaqësues të dhomës kurse **Ligjin për AKP**-në si një rregullore të thjeshtë të brendshme që duhej zbatuar e respektuar vetëm nga ana e agjencisë kosovare **de facto,** e cila quhej **AKP**. Thënë me fjalë tjera, pas pavarësimit të Kosovës, misioni **EULEX** që kishte për qëllim promovimin e sundimit të ligjit në **Kosovë**, nga i cili paguheshin gjyqtarët dhe stafi tjetër i dhomës, nuk pranonte se ligji kosovar kishte statusin e ligjit dhe që, për pasojë, institucioni i **AKP**-së paraqiste zëvendësin kushtetues e ligjor të

---

179 Cf. më shumë në lidhje me këtë në një studim elokuent nga Csongor Kuti, *Post-Communist Restitution and the Rule of Law* (Central European University Press: Budapest/New York: 2009)

180 Cf. më shumë në lidhje me këtë në një artikull në shqip, me një rezyme në anglisht, të shkruar nga Haxhi Gashi, "Konflikti lidhur me privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore: ndryshimi i Ligjit për Dhomën e Veçantë të Gjykates Supreme, i Ligjit për AKP-në dhe ligjeve relevante". *E DREJTA/LAW* Nr. 2/2011 fq. 47-63.

181 **Rregullorja nr. 2002/12 për Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit e** datës 13 qershor 2002. Në internet: http://www.unmikonline.org/regulations/2002/RE2002_12.pdf (shikuar në dhjetor 2018)

182 **Rregullorja nr. 2002/13 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Ndërlidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit**, me ndryshime, e datës 13 qershor 2002. Në internet: http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/02english/E2002regs/RE2002_13.pdf (shikuar në dhjetor 2018).

183 **Ligji nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.** *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* nr. 30/2008 e datës 15 qershor 2008.

184 Fjala është për **Ligjin nr. 03/L-053 për juridiksionin, përzgjedhjen e dhe caktimin e rasteve, të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë** të datës 13 mars 2008. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* nr. 27/2008 e datës 3 qershor 2008.

AKM-së**. EULEX**-i, pjesë e të cilit ishte dhoma, nuk pranonte se pas pavarësisë së Kosovës **AKM**-ja e kishte për detyrë që të dorëzonte të gjitha punët e veta tek **AKP**-ja kosovare.

Qasja e dhomës, përveç sa më sipër, në mënyrë efektive linte të kuptohet se sovran ishte vetëm **EULEX**-i, nga i cili paguheshin gjyqtarët dhe stafi tjetër i saj, përkatësisht se kishte të drejtën për të punuar në mënyrë të ndarë nga **Gjykata Supreme** si organi më i lartë gjyqësor në **Republikën e Kosovës**. Në aspektin juridik-kushtetues, ndërkaq, **EULEX** nuk ishte sistem paralel i drejtësisë në Kosovë, por pjesë përbërëse e tij, përfshirë edhe Gjykatën Supreme, ku ishte e integruar dhoma. Me këtë qëndrim të **EULEX**-it, përkatësisht të dhomës si pjesë e tij krijohej një pasiguri totale juridike në sistemin e ri juridik-kushtetues të Kosovës, përkundër faktit se vetë dhoma **de jure** ishte pjesë përbërëse e organit më të lartë gjyqësor kosovar, **Gjykatës Supreme**, dhe kishte detyra dhe përgjegjësi të njëjta kushtetuese e ligjore me të - sigurimin e zbatimit unik të ligjit në tërë territorin e **Kosovës**. Shkaktimi i pasigurisë juridike në Kosovë binte ndesh **prima facie** me vetë misionin primar të misionit **EULEX**, pjesë e të cilit ishte dhoma.

Aktgjykimi nr. KI **25/10** i datës 30 mars 2010, me të cilin u rrëzua vendimi i dhomës si më sipër, konstatonte se ai vendim binte në kundërshtim me shumë norma dhe vlera të Kushtetutës së vitit 2008. Në fokus të diskutimit tonë, megjithatë, nuk është analiza që Gjykata Kushtetuese ua ka bërë shkeljeve të dispozitave të veçanta të Kushtetutës dhe vlerave të saj thelbësore të kryera nga Dhoma përmes vendimit në fjalë,[185] por pjesa në lidhje me shkeljet e kryera që kanë të bëjnë me **pouvoir constituant originaire.** Këtë pushtet konstitutiv, të cilin, sipas verdiktit të Gjykatës, e ka cenuar Dhoma, **Kosova** e ka fituar në momentin e shpalljes së pavarësisë. Me një qasje doktrinare **par exellence**, Gjykata mori një kthesë tjetër lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit si më sipër të Dhomës. Nuk ndryshonte asgjë në aspektin juridik-kushtetues fakti se vendimi ishte dhënë nga një trup i ndërkombëtarizuar i organit më të lartë gjyqësor në vend, **Gjykatës Supreme të Kosovës**. Qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese në këtë rast shmangej nga ajo që do të mund të pritej nga ajo, përkatësisht nga trajtimi i shkeljeve të të drejtave kushtetuese, të cilat i pohonte paraqitësi i kërkesës (ankuesi).

E përbërë nga gjyqtarë ndërkombëtarë si pjesë e misionit **EULEX**, Dhoma ishte themeluar me qëllim për të ndihmuar sundimin e ligjit në **Kosovë** në fazën e pavarësisë së mbikëqyrur të Kosovës dhe pas saj deri në krijimin e një sistemi të qëndrueshëm të drejtësisë në vend. Ajo, megjithatë, kishte marrë një qëndrim që shkonte ndesh pikërisht me këtë mision të saj primar. Ky qëndrim që binte ndesh me misionin e saj primar ka qenë fokus i analizës së Gjykatës me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së vendimit si më sipër.

Analiza gjendet në paragrafin 54 të Aktgjykimit, ku Gjykata Kushtetuese ia bën të qartë Dhomës, e cila kishte refuzuar zbatimin e ligjit të ri të Kosovës që themelonte **AKP-**në dhe shfuqizonte **Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12** dhe **AKM-**në, në një mënyrë shumë profesionale, se pushteti konstitutiv origjinal, **pouvoir constituant originaire,** i organeve të **Kosovës** nuk bazohet në normat e rendit juridik të themeluar nga **UNMIK**-u në bazë të **Rezolutës 1244**. Ky pushtet bazohet në vullnetin konkret politik dhe historik të një populli, popullit të Kosovës. Këtë vullnet, populli i Kosovës e ka shprehur më datën 17 shkurt 2008, me aktin e shpalljes së pavarësisë, duke mos u bazuar në asnjë normë apo rend pararendës juridik të instaluar nga **UNMIK**-u pas datës 10 qershor 1999. Ky pushtet origjinal konstitutiv, **pouvoir constituant originair**, thënë ndryshe, tejkalon të gjitha normat ekzistuese dhe u jep fund kompetencave dhe autorizimeve të të gjitha autoriteteve të dala nga rendet tjera në fuqi deri me lindjen e vetes së tij më datën 17 shkurt 2017. Në rastin konkret, kjo nënkuptonte se ishin kosovarët ata që normave të rendit juridik kosovar në fuqi para datës 17 shkurt 2008 mund t'u jepnin fuqi, shpirt dhe kuptim konkret, dhe atë vetëm nëse donin, assesi anasjelltas.

Nuk ishin ndërkombëtarët ata që vendosnin për statusin e kompetencave të organeve të reja të **Kosovës** dhe të ligjeve që i kishin themeluar ato, por vetë kosovarët dhe organet e tyre. Kjo nga shkaku se janë kosovarët ata që, pas fitimit të pavarësisë, për herë të parë filluan të ushtrojnë këtë

[185] Cf. *Aktgjykimi në rastin nr. KI 25/10,* paragrafët 45-53 dhe 55-62.

pushtet të ri, këtë **pouvoir constituant originair**, pushtet i ri dhe origjinal, ngaqë buron nga një rend i i ri juridik, i ndryshëm nga rendi juridik i mëparshëm që ishte krijuar nga **UNMIK**-u, duke u bazuar në **Rezolutën 1244**. Ky verdikt me këtë arsyetim i Gjykatës Kushtetuese, në fund e detyronte Dhomën që të respektonte në tërësi statusin e **AKP**-së dhe në mënyrë graduale të fillonte bartjen në **AKP** të të gjitha autorizimeve rreth udhëheqjes së procesit të privatizimit në Kosovë, kurse **Ligjin nr. 03/L-067** ta trajtonte ashtu siç është – një shprehje e vullnetit të sovranit të ri kosovar.

Në vijim të analizës si më sipër, ushtrimi i këtyre kompetencave nga organet kosovare, në këtë rast nga ana e **AKP**-së, që nga shpallja e pavarësisë e tutje nuk paraqiste shkelje të asnjë norme të veçantë apo të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, kishte thënë Gjykata duke iu referuar mendimit këshilldhënës të **GJND**-së për Kosovën.[186] Me këtë Gjykata në mënyrë të qartë tregonte se vetë dhoma është pjesë e pandashme e rendit të ri kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës dhe ka detyrim jo vetëm për ta respektuar këtë rend por edhe për t'i dhënë jetë konkrete në praktikë. Kjo tutje nënkuptonte se nuk i takonte dhomës asaj që të zgjedhë sipas tekeve dhe dëshirës se cilat ligje apo norma juridike kosovare duhen zbatuar në vendosjen për një rast apo mosmarrëveshje konkrete. Ajo nuk e kishte të drejtën ligjore që t'i cilësonte si entitete **de facto** organet ligjërisht të formuara në vazhdën e ushtrimit të **pouvoir constitue,** të cilat funksionojnë sipas kushtetutës dhe ligjeve të reja të Kosovës sovrane dhe të pavarur. Në këtë mozaik të ri normash kushtetuese e ligjore, institucionesh e organesh të reja, dhoma është dashur të shërbejë si pjesë integrale e **Gjykatës Supreme të Kosovës**, funksioni kryesor i së cilës është që të sigurojë zbatimin e njëtrajtshëm të ligjit në tërë territorin e Republikës. Në thelb ky është pikërisht roli dhe detyra e çdo gjykate supreme ose e një ekuivalenti të ngjashëm që ka gradën më të lartë të gjyqësisë në një vend të caktuar (**funksioni nomofilaktik**). Ky ishte, **grosso modo**, thelbi i arsyetimit të Gjykatës Kushtetuese.

Me këtë arsyetim si më lart, Gjykata Kushtetuese në dispozitivin e vendimit të vet kishte shpallur si jo kushtetues vendimin si më sipër të dhomës, duke u shërbyer në tërësi me arsyetimin e GjND-së të dhënë në mendimin këshilldhënës lidhur me Deklaratën e Pavarësisë. Duke u mbështetur në këtë arsyetim të **GJND**, Gjykata ka theksuar se Dhoma asnjëherë nuk ka pasur të drejtën e moszbatimit të ligjeve të Kosovës, në rastin konkret moszbatimin e **Ligjit nr. 03/L-067**, të cilin dhoma kishte refuzuar ta zbatojë, si dhe të drejtën e mosrespektimit të organeve të themeluara konform ligjeve të Kosovës, në rastin konkret mosrespektimin e **AKP**-së, të cilin dhoma e kishte trajtuar si një entitet **de facto**, përkundër faktit se me ligj të ri pikërisht **AKP** duhej të merrte në përgjegjësi të saj udhëheqjen e procesit të privatizimit në **Kosovë**. Kjo qasje e Gjykatës ishte në pajtim të tërësishëm me **Planin Ahtisari** dhe me **Kushtetutën e Republikës së Kosovës**, të cilat stipulonin se **Kosova** detyrohej të zbatojë normat juridike dhe aktet e **UNMIK-**ut, por jo pafundësisht. Për vazhdimin e zbatimit të tyre ishin paraparë tri kushte: *e para*, që vetë atyre normave dhe akteve të **UNMIK**-ut të mos u kishte skaduar afati i fuqisë juridike; *e dyta*, që autoritetet e reja kosovare të mos kishin nxjerrë ende ligje e akte që zëvendësojnë të vjetrat e nxjerra nga **UNMIK**-u; dhe, së fundi, që kurdo që të nxirreshin këto norma e akte të reja të Kosovës sovrane dhe të pavarur, të njëjtat mos të binin ndesh me **Planin Ahtisari** dhe me **Kushtetutën e Republikës së Kosovës**.

Rasti i **AKP**-së bën pjesë në mesin e atyre situatave që nuk kapin vëmendjen e publikut të gjerë. Sa i përket sundimit të ligjit dhe sigurisë juridike, megjithatë, ky rast është i një rëndësie të madhe sepse i

[186] Fjala është konkretisht për paragrafët 52-56; 74-84; 96-109; 114-121 të **Mendimit të GJND për Kosovën**, të cilët i kishte pasur parasysh Gjykata Kushtetuese. Në aktgjykimin e saj, Gjykata i referohet mendimit të **GJND-së** për Kosovën vetëm në një paragarf, në paragrafin 54. Ky paragraf vjen si përgjigje ndaj qëndrimit të **Dhomës së Posaçme,** të përshkruar në paragrafin paraprak, në paragrafin 53 të Aktgjykimit, qëndrim që në mënyrë efektive e injoronte ekzistimin e **Kosovës** si shtet sovran the i pavarur dhe i ligjeve që buronon nga Kuvendi i Kosovës. Kjo përgjigje, e dhënë në paragrafin 54 si më sipër, thoshte si vijon: "[…] 54. Ne lidhje me këtë, Gjykata i referohet Opinionit Këshillimor të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të 22 korrikut 2010, sipas të cilit miratimi i shpalljes së pavarësisë, më 17 shkurt 2008, nuk ka shkelur ligjin e përgjithshem ndërkombëtar, Rezoluten e Këshillit të Sigurimit 1244 (1999) apo Kornizën Kushtetuese. Sipas mendimit te Gjykatës, themelimi i Republikës së Kosovës si shtet i pavarur, sipas deklarates së pavarësise dhe shtetësia e së ciles ishte njohur, deri më tani, nga 75 shtete, prandaj nuk është në kundërshtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244(1999) si dhe të drejtën ndërkombëtare, parimeve që duhet t'iu përmbahet Republika e Kosovës, siç është e parashtruar në nenin 16 (3) të Kushtetutës, që përcakton se 'Republika e Kosovës respekton të drejtën ndërkombëtare'."

vuri themelet e precedentit në gjyqësinë kushtetuese kosovare që detyron organin më të lartë gjyqësor në vend, Gjykatën Supreme, që të sigurojë zbatimin uniform të ligjit nga ana e të gjitha gjymtyrëve të saj. Në gjykatat supreme nacionale, si dhe në gjykatat tjera të barasvlefshme me to, që në shumicën e rasteve quhen gjykata të larta, zakonisht ekzistojnë dhoma (administrative, penale, civile dhe kushtetuese). Këto dhoma asnjëherë nuk gëzojnë subjektivitet të ndarë nga organi më i lartë gjyqësor në vend, të cilit i takojnë dhe pjesë përbërëse e të cilit janë. Kjo nënkupton se roli i të gjitha dhomave, në kuadër të fushëveprimtarisë së tyre, duhet të jetë unifikues në çështjet e zbatimit uniform të ligjit nacional (**funksioni nomofilatik**). Këtë funksion, dhomat e ushtrojnë së bashku me dhomat tjera në kuadër të strukturave të brendshme të përbashkëta të ndërtuara brenda gjykatës më të lartë në vend. Secila prej dhomave, ndërkaq, detyrohet që t'i veçojë situatat që shpërfaqen para tyre, që mund të çojnë kah moszbatimi uniform i ligjit dhe t'i raportojnë të njëjtat në mbledhjet e përbashkëta të dhomave me qëllim të veprimit unifikues në zbatimin e ligjit.

Nga përshkrimi i rastit të **AKP**-së si më sipër, lehtë mund të vërehet se çështja kryesore ka pasur të bëjë me një ankesë kushtetuese që pohonte shkeljen e disa të drejtave kushtetuese të parashtruesit të saj (barazia para ligjit, mbrojtja gjyqësore e të drejtave etj. etj.). Arsyetimi i Gjykatës në këtë rast, megjithatë, prek segmentet më vitale të sundimit të ligjit: jo parashikueshmërinë dhe pasigurinë juridike që shkaktohej nga një zbatim jo uniform i ligjeve nga autoriteti më i lartë gjyqësor, **Gjykata Supreme e Kosovës**, pjesë integrale e së cilës ishte dhoma. Fakti që dhoma përbëhej nga gjyqtarët ndërkombëtarë, si pjesë e ndihmës teknike që Evropa i ka dhënë Kosovës në sferën e sundimit të ligjit, nuk ndryshon asgjë në këtë konstatim. Qasja e saj, përkundrazi, dëshmon për të kundërtën e asaj që misioni **EULEX** supozohej se duhej ta bënte në Kosovë, përkatësisht të promovonte sundimin e ligjit dhe sigurinë juridike në tërë Kosovën. Ky promovim i mossundimit të ligjit dhe i pasigurisë juridike bëhej me pretekstin se dhoma kishte të drejtën për të zbatuar ligjet në fuqi sipas tekeve dhe preferencave të saj të momentit, duke ua mohuar disa ligjeve kosovare statusin e ligjit. Argumenti kryesor i Gjykatës Kushtetuese se kjo nuk mund të bëhej ka qenë arsyetimi i **GJND**-së i dhënë në mendimin e saj këshilldhënës për **Kosovën**. Esenca e argumentit konsiston në dallimin që **GJND** ka bërë në mes të pushtetit origjinal konstitutiv, **pouvoir consituant originaire**, dhe pushtetit të prejardhur, **pouvoir constitué**. Në grupin e parë bëjnë pjesë veprimet e përfaqësuesit të sovranit kosovar që janë kryer me rastin e shpalljes së pavarësisë së **Kosovës** dhe nxjerrjen e kushtetutës respektivisht më datat 17 shkurt dhe 15 prill të vitit 2008, kurse në grupin e dytë hyjnë të gjitha organet dhe institucionet e Kosovës, të cilat kanë mandat kushtetues dhe ligjor për të vënë në jetë vullnetin e sovranit kosovar të skicuar në dy veprimet e mësipërme të muajve shkurt dhe prill të vitit 2008 si dhe çdo vullnet tjetër që sovrani kosovar mund ta shprehë dhe të manifestojë në të ardhmen përmes amendamenteve kushtetuese, ligjeve dhe akteve tjera që kanë natyrë juridike.

10.4. Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe dizajni kushtetues aktual

Dizajni kushtetues i Kosovës, i bazuar në Kushtetutën e vitit 2008, ka disa veçori të përgjithshme dhe disa të posaçme. Në të parat bëjnë pjesë veçoritë që lidhen me mënyrën e organizimit të pushtetit në Kosovë, përkatësisht me llojin e demokracisë ndër ne dhe modeli institucional brenda të cilit ushtrohet pushteti politik. Në të dytat, ndërkaq, hyjnë ato cilësi që lidhen me kontekstin shumë specifik, **sui generis**, kosovar dhe ankorohen kryesisht në dispozitat e Kushtetutës që gjenden në kapitujt e saj dy dhe tre: karta për të drejtat e njeriut në Kosovë, e gjendur në këta dy kapituj, përbën përgjigjen më të thellë dhe më dramatike të Kosovës ndaj të kaluarës së saj tragjike. Jo vetëm kaq!

Krahas këtyre dy kapitujve, një cilësi tjetër që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me vënien e tyre ë jetë është vetë modeli juridiksional i gjyqësisë kushtetuese kosovare: pasja e një gjykate të ndarë kushtetuese, me juridiksion të qartë kushtetues dhe të ndarë nga gjyqësori i rregullt, pra një gjyqësi e modelit **evropian/kelsenian** në formë me një ankesë kushtetuese të llojit të plotë që garanton qytetarin e Kosovës se kapitujt dy dhe tre, karta kosovare për të drejtat e njeriut, nuk është vetëm një hapësirë programatike ku shteti zbrazë disa dëshira e qëllime propagandistike pa asnjë vlerë praktike. Ky juridiksion, krahas atij që lidhet me kontrollin kushtetues të organizmit të pushtetit, atij qendror dhe lokal, si në nivel të ligjvënies

ashtu edhe në atë të vendimmarrjes individuale të secilës degë të pushtetit, përbën një tërësi organike që i jep vulë sistemit kosovar të demokracisë kushtetuese. Thënë me fjalët e një laiku, demokracia kushtetuese kosovare, jo vetëm që nuk është demokraci e shumicës, por nuk është as e pakicës. Ushtrimi i pushtetit në nivel vertikal dhe horizontal mund të bëhet vetëm sipas standardeve të kapitullit të dytë dhe të tretë e që mund të përmblidhet me fjalinë si vijon: sundimi i Kushtetutës dhe i ligjit si dhe respektimi i të drejtave të njeriut dhe të bashkësive të **Kosovës** përshkojnë secilën hallkë të pushtetit dhe mënyrën e ushtrimit të tij, me **GJKRKS** si organin e fundit me monopol ekskluziv për të siguruar supremacinë (epërsinë) e Kushtetutës dhe të rendit objektiv që bazohet në te.

T'i kthehemi tani veçorive një nga një, atyre të përgjithshme dhe të veçanta, të cilat reflektohen në dizajnin kushtetues kosovar.

Në grupin e veçorive të llojit të parë bie veçoria e të drejtës kushtetuese kosovare si një e drejtë ish-komuniste në tranzicion. Kjo do të thotë se Kushtetuta e vitit 2008 nuk bën një prerje (shkëputje) cezarike me të kaluarën e Kosovës, gjë që vërehet në dispozitat e saj të natyrës kalimtare dhe të fundit.[187] Kjo nënkupton se teksti kushtetues ka për synim parësor, sikur në vendet tjera në tranzicion, të tejkaloj gjendjen e kaluar dhe të shtyjë shoqërinë drejt një sistemi tjetër, që cilësohet si një sistem demokratik i qeverisjes, ku nuk ka monopol ideologjik, pronësor dhe tjetër në çështjet e pushtetit dhe organizimit të jetës publike. Në këtë kuptim, secila e drejtë në tranizcion ka dy funksione në të njëjtën kohë: funksionin e ndryshimit dhe atë të normimit të asaj që vjen në të ardhmen, përkundër faktit që vetë e drejta, përfshirë të drejtën kushtetuese pozitive, janë pjesë dhe prodhim primar i këtij tranzicioni. Në Kosovë, ky tranzicion, sikundër dihet, nuk ka filluar si në rastin e vendeve tjera ish komuniste për arsye të instalimit në Kosovë të regjimit represiv millosheviqian në vitet 1989-1999. E drejta kushtetuese kosovare, megjithatë, bën pjesë në llojin e të drejtave në tranzicion në po atë mënyrë siç ka qenë rasti me të drejtat kushtetuese të krejt vendeve ish-komuniste në Evropë: Kushtetuta e vitit 2008 është po ashtu prodhim i tranzicionit, të cilin synon ta ndryshojë duke normuar në mënyrë krejtësisht tjetër nga e kaluara marrëdhëniet kardinale socio-politike, socio-ekonomike dhe socio-kulturore në vend. Kjo është kështu sepse, siç e thot **Ruti Teitel,**[188] dispozitat kushtetuese të vendeve në tranzicion janë të hartuara në mënyrë që të shërbejnë si një instrument i ndryshimit po edhe si instrument i largimit nga traditat kushtetuese dhe politike të së kaluarës.

Veçoria e dytë e natyrës së përgjithshme, në vijim si më sipër, ka të bëjë me modelin e qeverisjes të cilin e ka ndjekur **Kosova** pas shpalljes së pavarësisë dhe njohjes së saj ndërkombëtare. Ai model ka qenë dhe mbetet model i demokracive kushtetuese perëndimore. Me këtë demokraci nënkuptohet, siç dihet, sistemi ku pushteti buron nga populli por ushtrohet sipas kushtetutës dhe ligjit. Kjo do të thotë se populli shpreh vullnetin e vet përmes përfaqësuesve dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë më referendum dhe përmes formave tjera të deklarimit të drejtpërdrejtë, kurse ushtrimi i këtij vullneti të shprehur nga populli kësisoj mund të bëhet vetëm sipas standardeve kushtetuese të operacionalizuara me ligje dhe akte tjera të përgjithshme dhe në asnjë mënyrë tjetër.[189] Në këtë kuptim, skeleti i organizimit të pushtetit politik kosovar është i njëjtë me vendet tjera të demokracive liberale perëndimore, ani se mund të jenë sisteme të

[187] Fjalën e kemi për kapitujt XIII ["Dispozitat Përfundimtare"] dhe XIV ["Dispozitat Kalimtare"] të Kushtetutës, të cilat janë fshirë pas mbarimit të pavarësisë së mbikëqyrur në shtator të vitit 2012, duke ngelur në fuqi vetëm ato dispzoita që kanë natyrë të përhershme dhe që mëtojnë për ta ndikuar strukturën kulturore të shoqërisë kosovare në të ardhmën. Cf. për komentet e këtyre kapitujve, çfarë kanë përmbajtur, si dhe për se janë fshirë në Enver Hasani, Ivan Cukalovic, *Kushtetuta e Kosovës. KOMENTAR* (GIZ: Prishtinë, 2013) fq. 673-707.

[188] Cf. fusnotën nr. 29 si më sipër dhe komentet tona aty.

[189] Cf. ta zëmë: neni 2.1 ["Sovraniteti"] i Kushtetutës: "[…] 1. Sovraniteti i Republikës së Kosovës buron nga populli, i takon popullit dhe ushtrohet, në pajtim me Kushtetutën, nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, me referendum, si dhe në forma të tjera, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute"; dhe neni 16.2. ["Epërsia e Kushtetutës"] i Kushtetutës: "[…] 2. Pushteti qeverisës buron nga Kushtetuta".

ndryshme të qeverisjes: organizimi i pushtetit, **grosso modo**, shpërfaqet përmes një pushteti legjislativ, një pushteti ekzekutiv dhe një pushteti gjyqësor, të cilët qëndrojnë në raport horizontal me njëri-tjetrin.

Kjo qartë bëhet e ditur edhe në kapitullin e parë ["Dispozitat Themelore"] të Kushtetutës se vitit 2008: neni 4 që flet për formën e qeverisjes dhe ndarjen e pushtetit, pa asnjë dykuptimësi numëron llojet e pushteteve, organet e autorizuara për ushtrimin e tyre si dhe definimin e mënyrë së ushtrimit të funksioneve themelore të këtyre pushteteve të ndara.[190] Kjo nënkupton se asnjëri prej tyre nuk është në marrëdhënie hierarkike kundrejt tjetrit, por në një marrëdhënie të ndarë dhe të balansuar që reflektohet në të gjitha sferat: organizative, juridiksionale, financiare dhe në sferën e personelit.

Kjo marrëdhënie jo hierarkike në rastin e organit legjislativ nënkupton atë se, ky organ, gjatë procesit të nxjerrjes së ligjeve, përfshirë dhe produktin përfundimtar, i nënshtrohet një kontrolli përfundimtar të një organi që quhet gjykatë kushtetuese. E thënë me fjalë të tjera, procesi dhe vetë produkti i prodhuar në të janë objekt kontrolli kushtetues nga ana e një gjykate kushtetuese. Përveç kësaj, në demokracitë kushtetuese, gjyqtari (i gjyqësisë së rregullt apo i asaj kushtetuese) nuk është vetëm një **bouche de la loi**, siç do të thoshte **Monteskije** (Montesquieu: 1689-1755) që ka për detyrë të implementojë një **volonté générale** në kuptimin e skicuar nga **Zhan Zhak Ruso** (Jean-Jacques Rousseau: 1712-1778), por një zëdhënës i vullnetit të kushtetutës dhe ligjit: të gjithë, përfshirë kuvendin si organ ligjvënës dhe si përfaqësues i vullnetit të popullit, i nënshtrohen kushtetutës dhe ligjit. Këta të fundit, pra ligjet, sipas një procedure të paracaktuar, i nënshtrohen kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë së tyre.

Kjo cilësi përshkon **Kosovën** dhe të gjitha vendet e tjera të demokracive kushtetuese. Dallon vetëm mekanizmi, apo modeli, sipas të cilës gjyqtari demonstron se nuk është vetëm një interpretues mekanik i normës kushtetuese dhe ligjore. Në modelin **evropian/kelsenian** ky mekanizëm quhet gjykatë kushtetuese, kurse në atë **amerikan** një gjë e tillë kryhet nga të gjitha instancat e mekanizmit të rregullt gjyqësor apo vetëm nga mekanizmi i instancës së fundit të gjyqësorit të rregullt. Kjo do të thotë se ka disa sisteme në kuadër të cilit janë jetësuar mekanizma të ndryshëm të interpretimit të normave kushtetuese e ligjore, duke lënë të kuptohet se ligjvënësi dhe përfaqësuesi i sovranit nuk është në tërësi sovran në kushtetutëbërje dhe në ligjvënie. Ky kontroll kushtetues i sovranit dhe vullnetit të tij të shprehur përmes kushtetutës dhe ligjeve, si një cilësi e demokracive kushtetuese të vendeve demokratike ku sundon kushtetuta dhe ligji, domosdo që ngjallë dilema dhe debate që njihen me emrin **vështirësia kundërmazhoritare**.

Me këtë term nënkuptohet dilema dhe problemi të cilin e kanë ndeshur dhe e ndeshin të gjitha vendet demokratike përgjatë historisë së zhvillimit të tyre politik dhe kushtetues, përfshirë këtu **Kosovën** dhe vendet ish-komuniste, dhe që mund të përmblidhen si vijon: si është e mundur që një grup gjyqtarësh, pa legjitimitet zgjedhor nga sovrani, të përcaktojnë formën, përmbajtjen dhe fuqinë e normës kushtetuese dhe ligjore dhe, në të njëjtën kohë, të shërbejnë

---

190 Neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] i Kushtetutës:
"1. Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ.
3. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë.
4. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar.
5. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat.
6. Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.
7. Republika e Kosovës ka institucionet e veta për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe të integritetit territorial, rendit dhe qetësisë publike, të cilat funksionojnë nën autoritetin kushtetues të institucioneve demokratike të Republikës së Kosovës".

si garantues të supremacisë (epërsisë) së kushtetutës si ligji më i lartë nacional që reflekton vullnetin më suprem të sovranit, pra jo vullnetin e gjyqtarëve garantues? Pse vetë sovrani mos të jetë garantues i kësaj supremacie (epërsie)? Jo rrallë kjo dilemë dhe ky problem është cilësuar, në diskursin bashkëkohor të së drejtës kushtetuese, si **paradoksi i konstitucionalizmit.**[191]

Në demokracitë kushtetuese të proveniencës liberale kjo dilemë dhe ky problem është zgjidhur përmes rrugës së thjeshtë: norma kushtetuese paraqet normën më supreme (më sipërore), së cilës duhet çdokush t'i nënshtrohet sepse gëzon një supremaci (epërsi) në çdo rast. Këtë supremaci duhet ta sigurojnë të gjitha organet kushtetuese, në hierarkinë e të cilave ekziston një organ që ka monopolin kushtetues për të siguruar një gjë të tillë, pra supremacinë (epërsinë) e kushtetutës si ligji më i lartë nacional. Ky organ quhet gjykata kushtetuese (ose organi tjetër i barasvelfshëm me te). Të gjithë duhet të veprojnë në bazë të kushtetutës dhe ligjit, por ky organ kushtetues ka këtë monopol, i cili shprehimisht garantohet me kushtetutë nacionale, pra monopolin për të treguar në fund se çka është normë kushtetuese dhe cila është përmbajtja e saj. Në disa raste, ky organ ka monopolin për të treguar edhe se çka është norma ligjore dhe cila është përmbajtja e saj. Në **Kosovë** kontrolli i ligjshmërisë nuk bëhet nga ana e **GJKRKS**, por vetëm nga ana e gjyqësorit të rregullt. Njëjtë si në vendet tjera të demokracive kushtetuese perëndimore, ku ekziston **modeli evropian/kelsenian**, në **Kosovë** kjo supremaci (epërsi) sigurohet përmes një organi tjetër të veçantë dhe me juridiksion të qartë kushtetues për një gjë të tillë. Sikundër u tha, monopoli për të thënë se çka është normë ligjore, nuk hyn në menynë e juridiksionit të gjyqësisë aktuale kushtetuese në Kosovë, siç është rasti në disa vende të tjera: dikur kontrolli i ligjshmërisë ka qenë prerogativë e **Gjykatës Kushtetuese të KSAK**, për shkak se ligjshmëria socialiste ka qenë emblemë e tërë sistemit kushtetues komunist ish-jugosllav.

Në rastin e ekzekutivit, marrëdhënia jo hierarkike konsiston në atë që njihet si parimi i ligjshmërisë, e që do të thotë se gjithë punën e vet ekzekutivi e kryen në bazë të kushtetutës dhe ligjit, njëjtë si çdo organ tjetër, mirëpo secili veprim i ekzekutivit i nënshtrohet kontrollit të ligjshmërisë. Kjo për arsye se vetëm një dizajn i tillë garanton se individi do të ketë marrëdhënie dinjitoze vertikale me pushtetin politik. Në kohën e rritjes së shtetit administrativ, shumë punë e kompetenca të ekzekutivit bartën për t'u kryer tek të tjerët, në organe e agjensi të tjera administrative. Këto i institucione, megjithatë, punën e tyre e kryejnë në bazë të ligjit. Si e tillë, puna e tyre i nënshtrohet kontrollit gjyqësor të ligjshmërisë. Kur bëhet fjalë për të drejtat e liritë e njeriut, vendime individuale të ekzekutivit i nënshtrohen edhe kontrollit të kushtetutshmërisë, por vetëm pasi të jenë shterur të gjitha procedurat tjera ligjore (qofshin ato procedura brenda gjyqësorit të rregullt apo në kuadër të instancave administrative të vendimmarrjes). Nga kontrolli i ligjshmërisë përjashtohen vendimet politike, të cilat i nënshtrohen

[191] Në diskursin shkencor, paradoksi i parë ka nisur në debatin **Hans Kelsen - Karl Shmit**, i diskutuar gjetiu në seksionin e dytë të kapitullit të tretë të këtij libri, lidhur me atë se kush duhet të jetë guardian i kushtetutës: ***Führer-i*** si përfaqësues i unitetiit absolut të popullit, unitet i kuptuar në aspektin sociologjik, apo një organ tjetër kushtetues jashtë spektrit të organeve politike. Ky organ jashtë këtij spektri, më vonë i njohur si gjykata kushtetuese, u konfirmua si më i besueshëm vetëm pas **Luftës së Dytë Botërore**. Përveç këtij paradoksi, pra që ruajtja e kushtetutës iu besua një organi jashtë spektrit politik, ekzisdtojnë edhe tjera paradoks kushtetuese, siç është ai që identifikohet me të a.q. **amendamentet jokushtetuuese**. Ky paradoks përmblidhet në pyetjen që kërkon përgjigje lidhur më atë se si është e mundur që një gjeneratë flet në emër të sovranit njëherë e përgjithmonë (përjetësisht). Me fjalë të tjera, ky paradoks konsiston në gjetjen e përgjigjes në pyetjen se si është e mundur që një gjeneratë që nxjerrë kushtetutën flet në emër të atyre që nuk kanë lindur, duke futur në teksitn kushtetues dispozita që nuk mund të amendamentohen asnjëherë apo mund të amendamentohen përmes një procedure jashtëzkaonisht të vështirë, aq të vështirë sa në praktikë gati thuajse është e pamundur që të bëhet amendamentimi i kushtetutës së parë në disa pjesë të caktuara të dispozitave të saj. Ky është rasti edhe me **Kosovën** dhe dispozitat e saj për amendamentim, në veçanti kur bëhet fjalë për çështjet që prekin të drejtat e komuniteteve kosovare, dy të tretat (2/3) e të cilave kërkohen për amendamentim. Për çështjen e paradoksit të konstitutcionalizmit në planin historik, komparativ dhe aktual bashkëkohor, cf. më shumë në Martin Loughlin, Neil Walker (eds.), *The Paradox of Constitutionalism* (autorë të ndryshëm më punimet e tyre, në këtë përmbledhje trajtojnë aspekte të ndryshme të këtij paradoksi, përfshirë edhe atë që ka të bëj me draft-amendamentet jo kushtetuese që nuk lejohet të futen në tekstin e kushtetutës ekzistuese). Kësaj çështje i kthehemi sërish në kapitujt në vijim, përfshirë dhe në pjesën që flet për juridiksionin e **GJKRKS për të kontrolluar kushtetutshmërinë e amendamenteve kushtetuese para miratimit të tyre në Kuvendin e Kosovës**.

kontrollit kushtetues nga **GKRKS**, e cila ka juridiksion origjinal ndaj tyre (dekretet dhe vendimet e qeverisë).

Në rastin e gjyqësorit, marrëdhënia johierarkike konsiston në pavarësinë e gjyqësorit në aspektin objektiv dhe në atë subjektiv. Në rastin e dytë fjala është për paanshmërinë e gjyqtarëve individualë me rastin e kryerjes së punëve të tyre primare - dhënies së drejtësisë. Kjo neve këtu nuk na intereson. Për ne ka rëndësi të diskutohet shumë shkurt pavarësia e gjyqësorit në kuptimin objektiv. Në këtë kuptim, gjyqësorit i ofrohen disa garancione dhe procedura që sigurojnë pavarësinë e tij kushtetuese. Ato garancione dhe procedura kanë të bëjnë me juridiksionin, zgjedhjen dhe emërimit e gjyqtarëve dhe, së fundi, menaxhimin e vetë gjyqësorit si një pushtet i ndarë. Lidhur me juridiksionin, ka shumë rëndësi që kushtetuta të përcaktojë bazat themelore të organizimit të gjyqësorit, të cilat baza më pastaj specifikohen me ligj të veçantë ashtu që çdo gjykim dhe çdo vendim të jetë në përputhje me kushtetutën dhe ligjin e jo sipas diktateve nga jashtë.[192] Ky aspekt i pavarësisë nuk do të kishte asnjë kuptim po të mos ishin edhe garancionet tjera për pavarësinë objektive të gjyqësorit që lidhen me procedurat e ndara dhe të veçanta për zgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve si dhe me garancionet e objektive për të penguar çdo ndërhyrje nga jashtë. Në fund, si aspekt i tretë i pavarësisë objektive paraqitet çështja e menaxhimit të gjyqësorit: në demokracitë kushtetuese zakonisht themelohen trupa të jashtëm dhe të paanshëm kushtetues që ngarkohen me punët e menaxhimit financiar dhe tjetër të gjyqësorit. Këto organe përbëhen kryesisht nga anëtarët e gjyqësorit dhe nga anëtarë të jashtëm, por të cilët nuk janë nga spektri politik. Si të tilla, ato ngarkohen, përveç menaxhimit të punës së gjyqësorit edhe me çështje tjera që kanë të bëjnë me rekrutimin, zhvillimin dhe disiplinimin e gjyqësorit me qëllim të sigurimit të parimeve kushtetuese të meritokracisë dhe profesionalizmit, sigurimit të barazisë në përzgjedhje dhe avancim dhe kështu me radhë. E kemi fjalën këtu për **këshillat gjyqësore**.[193]

Si dimension i fundit që ndikon në forcimin, sigurimin, balansimin dhe ndarjen e pushtetit politik, është dimensioni i **institucioneve dhe agjensioneve të pavarura**. Këto paraqesin organizma kushtetuese, të cilët kryejnë punë të caktuara publike në mënyrë të pavarur, të cilat u janë deleguar me ligj dhe që mbikëqyren nga ana e organit përfaqësues. Lëmenjtë në të cilat themelohen këto institucione dhe agjenci të pavarura janë shumë të ndryshme dhe përfshijnë thuajse çdo sferë të jetës dhe punës në një vend.[194]

Nga këto veçori të përgjithshme burojnë veçoritë e tjera të veçanta të dizajnit aktual kushtetues të **Kosovës**. Këto veçori të veçanta janë pak a shumë të ndërlidhura me kontekstin kosovar, pra burojnë nga fakti se vendi ka pasur një trajektore tjetër të zhvillimit social, politik, ekonomik, kulturor dhe tjetër krahasuar me vendet tjera ish-komuniste të **Evropës.** Kjo trajektore e bën **Kosovën** më të ndryshme nga vendet e tjera ish-komuniste të **Evropës.** Kjo rrethanë shpjegon edhe faktin pse në kushtetutë ekzistojnë disa dispozita, të cilat më herët, në historinë kushtetuese kosovare, kanë qenë krejt të panjohura. Në mënyrë të dukshme, dispozitat e tilla, me rastin e zbatimit të tyre në praktikë pas qershorit të vitit 2008, kanë shkaktuar keqkuptime serioze në diskursin publik, jo vetëm atë laik por, mbi të gjitha, në diskursin akademik dhe politik. Shkak për këtë është fakti se vënia e tyre në Kushtetutën e vitit 2008 nuk ka qenë prodhim i vendorëve, por i hartuesve ndërkombëtar të tekstit të saj. Një vënie si kjo e tyre, siç mund të paramendohet fare lehtë, nuk ka qenë e paraprirë nga një përgatitje paraprake e opin-

---

[192] Cf. kapitullin e VII-të ["Sistemi i Drejtësisë"] të Kushtetutës. Në këtë kapitull normohen të gjitha institucionet kryesore të sistemit të drejtësisë, gjykatat dhe llojet e tyre, juridiksioni dhe organizimi i brendshëm, prokurori shtetit, këshillat gjyqësorë dhe prokurorial dhe avokatia si profesion i pavarur.

[193] Cf. nenet 104 – 108 të Kushtetutës që flasin për procedurat dhe kushtet për zgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve, si dhe për rolin vendimtar të **Këshillit Gjyqësor**, i cili për nga përbërja e vet ofron garancione të mjaftueshme për pavarësinë objektive të gjyqësorit; Cf. për rëndësinë e **këshillave gjyqësore** dhe rolin pozitiv të tyre në sigurimin e pavarësisë së gjyqësorit, në Zaid Al – Ali, "Constitutional drafting and external influence". Në Tom Ginsburg and Rosalind Dixon, *Comparative Constitutional Law* (Edward Elgar: USA, 2011) fq, 77- 95 në fq. 85 & 87.

[194] Cf. Kapitulli XII ["Institucionet e Pavarura"] I Kushtetutës.

ionit publik kosovar për përmbajtjen e dispozitave të tilla kushtetuese si dhe për implikimet e tyre në praktikë në të ardhmen. Kjo nuk ka ndodhur kështu vetëm me **Kosovën**.

Faktori ndërkombëtar ka fituar një peshë të madhe në modelimet e proceseve të kushtetutëbërjes pas rënies së komunizmit. Ky fenomen ka mundur të ndodhë vetëm pas krijimit të rrethanave të reja me mbarimin e **Luftës së Ftohtë.**[195] Kjo nuk do të thotë se më herët nuk ka pasur përpjekje për modelimin e kushtetutëbërjeve në vendet tjera. Të tilla **përpjekje ndërkombëtare** për të ndikuar në sistemet e brendshme kushtetuese të vendeve të **Botës së Tretë** kanë ekzistuar shumë më herët dhe njihen si përpjekjet e vendeve të **konsensusit të Uashingtonit**.[196]

Rasti i **Kosovës,** megjithatë, është i veçantë në këtë aspekt. Kjo për shkak se ndërhyrja ndërkombëtare ka qenë jo vetëm e natyrës formale, por edhe një ndërhyrje thellësisht substanciale. Për dallim nga vendet e tjera ish-komuniste në **Evropë,**[197] faktori ndërkombëtar në **Kosovë** ishte thuajse autori i parë i tekstit aktual kushtetues. Kjo gjë vërehet fare lehtë nga dallimet sintaksore dhe dallimet tjera që shpërfaqen në strukturën e tekstit në gjuhën angleze në krahasim me tekstin e njëjtë në gjuhët shqipe dhe serbe, si dy gjuhë të barabarta kushtetuese. Nga një krahasim i tillë mund shihet se versioni i parë dhe origjinal i Kushtetutës së vitit 2008, ka qenë versioni në gjuhën angleze, i cili nuk ka asnjë gabim në radhitje të mendimeve dhe në qartësinë e dispozitave kushtetuese, gjë që nuk është rasti me versionet në shqip dhe serbisht. Këtë shpërputhje me pasoja praktike e ka vërejtur dhe shënuar **GKRKS** në disa prej vendimeve të veta. Kjo mund të shihet në vendimet që i diskutojmë në kapitullin e fundit të këtij libri.

Këtu nuk bëhet fjalë për një problem gjuhësor, por për shpjegim të një fenomeni që lidhet me gjenezën e formimit të tekstit aktual të Kushtetutë së vitit 2008. Se kjo është kështu, mund të argumentohet përmes analogjisë me një zbulim të filologëve evropianë në fund të shekullit XVIII dhe në fillim të shekullit XIX. Atëbotë, ata zbuluan se gjuha hebraike, si gjuhë me status hyjnor, nuk kishte qenë gjuha në të cilën ka komunikuar **Zoti** me njeriun e parë në kopshtin e **Edenit.** Kjo qasje konstruktive e filologëve evropian, thënë me një fjalë, zbuloi se gjuha e folur nga **Jezu Krishti**, gjuha hebraike, nuk ishte gjuha më e vjetër në botë dhe se vetë gjuhët nuk mund të kishin status hyjnor meqë ishin krijesa njerëzore, jo hyjnore. Një

---

[195] Me mbarimin e **Luftës së Ftohtë** u bë e qartë se konstitucionalizmi modern bazohet në tregun e lirë, në pluralitetin e pronave dhe të ideve, në respektin për të drejtat njerëzore dhe liritë fundamentale, në sundimin e ligjit dhe në postulate të tjera të ngjashme me këto. Cf. më shumë për këtë në Laura Montanari, "Le nuove democrazie dell'Europa centro-orientale", botuar në P. Carrozza, A. Di Giovine & G. F. Ferrari (eds.), *Diritto costituzionale comparato*, fq. 514-553; Hakan Yilmaz, "The International Context". Në Christian W. Haerpfer, Patrick Bernhagen, Ronald F. Inglehart, Christian Welzel (eds.), *Democratization*. Second Edition (Oxford Univeristy Press: Oxford 2019) fq. 103-118, në veçanti fq. 106-111.

[196] Në fakt, këto përpjekje të kësaj kohe, të njohura si **konsensusi i Uashingtonit** kanë pasur më shumë të bëjnë me luftën kundër komunizmit, pra sforcimin e trendeve liberaliste në ekonominë dhe politikat e vendeve të **Botës së Tretë**, pa pasur ndonjë mekanizëm që do të siguronte se demokracia do të jetë alternativa e rrezikut komunist. Këto përpjekje kryesisht lidhen me **BB** dhe **FMN,** si dy institucione kryesore ndërkombëtare, me ndikim të madh amerikan dhe perëndimor, dhe politikat e tyre të kredidhënies dhe të ofrimit të ndihëm ekonomike vendeve të **Botës së Tretë** në mënyrë të kushtëzuar, përkatësisht duke i kushtëzuar vendet e varfëra të **Botës së Tretë** me reforma të caktuara në sistemin politik-kushtetues që lidhen me tregun e lirë, sigurimin e pronës private dhe të investimeve të huaja, pluralizmin politik dhe, nganjëherë, edhe me të drejtat e liritë njerëzore. Cf. më shumë në John Ëilliamson, "What Washington Means by Policy Reform." Në John Williamson (ed.), *Latin American Readjustment: How Much Has Happened* (Institute for International Economics: Washington, 1989*); Journal of Libertarian Studies* Volume 18, no. 1 (Winter 2004), fq. 89–98 Zaid Al-Ali, "Constitutional drafting and external influence", fq. 85.

[197] Në literaturë është vërejtur se ndikimi i perendimorëve në vendet ish-komuniste në procesin e kushtetutëbërjes ka ndodhur përmes paraqitjes së instrumenteve mbi të drejtat e njeriut si diçka universal ashtu që vendorët kanë pasur pak hapsirë për të refuzuar përfshirjen e tyre në kushtetutat nacionale. Cf. Kushtrim Istrefi and Visar Morina, "Judicial Application of International Law in Kosovo " Në Sinisa Rodin & Tamara Pwrisin (eds.), *Judicial Application of International Law in Southeast Europe* (Springer-Verlag Berlin Heidelberg, 2015) fq. 165-198 në fq. 169 (autorët citojnë ekspertin e njohur **Lech Garilcki**, që thot se e drejta ndërkombëtare në përgjithësi dhe ajo mbi liritë dhe të drejtat e njeriut në veçanti kanë shërbyer si instrumente për peentrim në sistemit kushtetues të ish-vendeve komuniste); Në mendojmë, megjithatë, se nuk ka qenë vetëm sfera e lirive dhe të drejtave të njeriut ajo që ka krijuar hapësirë për ndërhyrje nga jashtë: në tërësi, vendet ish – komuniste kanë pranuar modelin e demokracive kushtetuese liberale si recetë për organizimin e tyre politik, pra jo vetëm sa i përket mardhënieve vertikale të pushtetit me individin). Cf. për mendim të ngjashëm edhe Finsik Korenica, Dren Doli, "Constitutional Rigidity in Kosovo: Significance, Outcomes, and Rationale". *International Law Review Online Companion* Vol. 2 No. 6 (January 2011) fq. 1-28 në fq. 3-4 (ku autorët theksojnë me të drejtë se Kushtetuta është rezultat i përpjekjeve shtetbërëse të ndërkombëtarëve dhe vetë **Planit Ahtisari** me qëllim të arritjes së ndërtimit të një shoqërie shumëetnike në Kosovë).

zbulim si ky filologjik, që thoshte se **sanskritishtja** ishte gjuha më e vjetër në botë, bëri që gjeografia dhe autorësia e gjuhës më të vjetër në botë të ndryshojë përgjithmonë: ai autor ishte vetë njeriu dhe komunikimet ndërmjet njerëzve, jo një fuqi e jashtme hyjnore, siç ishte besuar deri atëherë, kurse gjeografia shkoi në territorin e **Indisë** së sotme. Ky zbulim nuk kishte pasoja filologjike, por civilizuese sepse zbuloi se nisja e civilizimit nuk ishte **Lindja e Mesme,** por **India** e sotme, aty ku ka lindur gjuha më e vjetër në botë – gjuha **sanskritishte.**[198]

Shtjellimi i mësipërm zbulon, **per analogiem**, çdo gjë rreth gjenezës së hartimit dhe vetë lindjes së Kushtetutës së vitit 2008 dhe autorëve të saj, përkatësisht rreth origjinës së draftimit të saj. Këto rrethana dhe faktet rreth lindjes së tyre zbulohen nga defektet gjuhësore në vetë strukturën e tekstit kushtetues. Këtë konstatim e provojmë me përvojën tonë personale në interpretimin e tekstit të Kushtetutës së vitit 2008 gjatë kohës gjashtëvjeçare sa kemi punuar në **Gjykatën Kushtetuese**. Përveç shpërputhjeve substanciale që ekzistojnë në mes të tekstit në gjuhën angleze dhe dy versioneve në gjuhët kushtetuese, asaj shqipe dhe serbe, në tekst ekzistojnë edhe lëshime të mëdha në dy gjuhët kushtetuese.[199] Këto lëshime serioze lehtë shpjegohen nëse i bëhet një analizë sintaksës dhe morfologjisë së gjuhës angleze të teksti të saj dhe krahasimit me gjuhët kushtetuese, gjuhën shqipe e serbe respektivisht. Një analizë e tillë shpejt çon në përfundimin se kanë qenë ekspertët ndërkombëtarë, të cilën gjuhën angleze e kanë pasur gjuhë amtare, ata që i kanë dhënë vulë procesit të hartimit të tekstit aktual të Kushtetutës së vitit 2008. Se kjo është kështu, e thonë vetë ata ekspertë të njohur ndërkombëtarë nga vendet mike të Kosovës që kanë marrë pjesë aktive në hartimin e saj,[200] apo që kanë shërbyer si korrigjues të pjesëve të caktuara të drafteve të Kushtetutës së vitit 2008[201]. **Si argument kyç i tërë kësaj shërben edhe fakti se teksti në gjuhën angleze nuk ka asnjë gabim gramatikor, në veçanti në sintaksë dhe morfologji: sistemi dhe struktura e gjuhës angleze e përdorur në Kushtetutën e vitit 2008 nuk duket që shoqërohet nga asnjë gabim serioz, gjë që nuk është rasti me dy gjuhët kushtetuese, me gjuhën shqipe dhe serbe respektivisht**.[202]

---

198 Edward Said, *Orientalism* (Vintage Books: New York, 29179) fq. 134-139.

199 Kështu, ta zëmë, në nenin 113.5 ["Juridiksioni dhë Palët e Autorizuara"] të Kushtetutës, version në gjuhën serbe nuk e figuron vendimi i **Kuvendit të Kosovës** si akt kushtetutshmëria e të cilit mund të sfidohet pranë Gjykatës me kërkesën e dhjetë (10) a më shumë deputetëve brenda afatit prej tetë (8) ditëve; Për ndikim e madh të vendeve perëndimore në draftimet e kushtetutave pas mbarimit të **Luftës së Ftoftë**, cf. edhe shkrimin e sipërcekur të Zaid Al-Ali, "Constitutional drafting and external influence", në fusnotën 196, **supra**, në këtë seksion, dhe teksti që e shoqëron.

200 Marc Weller*, Shtetësia e kontestuar. Admimnistrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi,* fq. 399-420.

201 Një fakt i tillë, pra mungesa e pronësisë lokale në procesin e draftimit të Kushtetutës së vitit 2008, ka qenë dhe ngelet një hendikep i elitës lokale në Kosovë. Këtë e konstatojnë më të drejtë këta autorë që kanë shërbyer si redaktorë të pjesëve të caktuara të tekstit të draft-Kushtetutës së vitit 2008. Cf. Joseph Marko, "The New Kosovo Constitution in a Regional Comparative Përspective". *Review of Central and East European Law* Vol. 33 No. 4 (2008) 437-450 (autori bën një analizë të shkëlqyer të procesit të draftuimit, llojit të dizajnit ksuhtetues dhe të sistemit të qeverisjes, mungesat në sistemiun gjyqësor, siç janë ato me mungesën e mjeteve juridike kundër akteve administrative; në këtë shkrim, ky autor sqaron, **inter alia**, edhe faktin se procesi i krijimit të Kushtetutës së vitit 2008 ka qenë rrepësisht i kontrolluar, kryesisht nga ekspertët amerikan, gjë që ka krijuar ndjenjën e mungesës së autorsisë lokale tek vendorët dhe, për pasojë, ka krijuar mungesë legjitimiteti të vetë kësaj kushtetute në sytë e elitës kosovare); Ngjashëm edhe Andrea Lorenzo Capussela, *State – Building in Kosovo. Democracy, Corruption and teh EU in the Balkans* (I.B. Tauris: London and New York, 2015) fq. 162-164.

202 "Projekt-Kushtetuta qe përkthyer në të gjitha gjuhët amëtare të Kosovës dhe ishte gati kur erdhi dita e pavarësisë në shkurt të vitit 2008". John Tunheim, "Rule of Law and the Kosovo Constitution" *Minnesota Journal of International Law* Vol. 18 Issue 2 (2009) fq. 371-379 në fq. 378 (**John Tunheim** ka qenë ndër këshilltarët kryesor amerikan, nëse jo më kryesori, në procesin e draftimit të Kushtetutës së vitit 2008; **J. Tunheim** tregon se procesi i draftimit të saj ka nisur në mars të vitit 2007 dhe ka përfunduar në dhjetor të atij vitit; koha tjetër deri në shpalljen e pavarësisë më 17 shkurt 2008, ka qenë kryesisht e dedikuar për përkthimin dhe korrigjim të tesktit; teksti përfundimtar, i përkthyer dhe i korrigjuar, u është dorëzuar Presidentit dhe Kryeministrit të Kosovës në prill të vitit 2008 për miratim).
Një tjetër këshilltar amerikan, profesori **Louis Aucoin**, që ka qenë me ndikim të madh në tërë procesin e draftimit të Kushtetutës së vitit 2008, tregon se pas përfundimit të draftit në dhjetor të vitit 2007, teksti i saj ka shkuar në diskutim publik përmes një veb faqeje të hapur për këtë qëllim. Sipas tij, diskutimi publik ka prodhuar propozime të panumërta mirëpo vetëm 30 përqind e neneve kanë pësuar ndryshime nga drafti original i dhjetorit 2007. Cf. Professor Louis Aucoin, "Views from the Field On Constitution Writing: The Case of Kosovo (Interview)", fq. 125.

Përdorimi në mënyrë analoge i analizës linguistike, e cila kishte zbuluar se gjuha hebreje nuk kishte qenë gjuhë hyjnore, por një gjuhë e shkruar nga njerëzit e një kohe, kurse sanskritishtja ishte "nëna e të gjitha gjuhëve", në rastin e Kushtetutës së vitit 2008 me një siguri të madhe vërteton se ka qenë anglishtja gjuha në të cilën ajo është shkruar, kurse **gjuhët vernakulare**, shqipja dhe serbishtja, kanë qenë gjuhë në të cilat është përkthyer teksti i saj në gjuhën angleze. Ky nuk ka qenë rasti me shumicën e vendeve tjera ish-komuniste.

Në vendet e tjera ish-komuniste në **Evropë**, ndërhyrja e faktorit të jashtëm, kryesisht nëpërmjet **Komisionit të Venecias** dhe inkurajimit të tyre për rrugën e anëtarësimit në **Bashkimin Evropian**, ishte në formë të ndihmës teknike nëpërmjet ekspertizës, duke i lënë hapësirë të madhe ekspertizës vendëse, me qëllim të futjes në kushtetutat e reja të këtyre vendeve të zgjidhjeve të ofruara kësisoj nga ekspertët evropianë dhe nga ekspertët e tjerë ndërkombëtarë.[203]

Ndihma ndërkombëtare në dizajnimin e kushtetues nacionale, përveç situatës si më sipër, në të shumtën e rasteve, historikisht shikuar, ka ndodhur me shoqëritë që kanë kaluar nëpër faza të represionit, të dhunës, të luftërave dhe të konflikteve të llojeve të ndryshme. Këto shoqëri kanë treguar më shumë prirje për pranim të ndihmës ndërkombëtare dhe futjen në tekstin kushtetues të dispozitave që kanë karakter ndërkombëtar. Këtë, zakonisht, e kanë bërë duke i inkorporuar instrumentet ndërkombëtare, apo duke i marrë ato si pikë referimi, nëpër tekstet e tyre kushtetuese të miratuara pas luftës apo pas konflikteve të tjera violente.[204] Historia violente dhe tragjike e këtyre shoqërive ka qenë përcaktuese e dizajnit të tyre kushtetues. Kjo nuk ka ndodhur me identitetin kushtetues të këtyre shoqërive: ai identitet është ruajtur edhe pas draftimit të dizajnit të ri kushtetues, duke i rezistuar kështu formave dhe praktikave të reja kushtetuese që vinin nga jashtë edhe për një kohë të gjatë.

Ky problem nuk është i ri dhe është hasur në të kaluarën e popujve antik: ajo që përcakton identitetin kushtetues të një shoqërie nuk ka të bëjë me "muret e qytetit", e ka thënë **Aristoteli**,[205] por me praktikat reale që kanë të bëjnë me mënyrën e organizimit dhe ushtrimit të pushtetit si dhe me vendin dhe me pozitën e njeriut në shoqëri.[206] Mbi bazën e kësaj edhe dallohen regjimet politike dhe dizajnet kushtetuese përkatëse. **Kosova** nuk përbën përjashtim në këtë drejtim. Për mënyrën e organizimit të pushtetit u fol më sipër: në këtë kuptim, **Kosova** nuk dallon nga vendet e demokracive kushtetuese perëndimore sepse pushteti në **Kosovë** ushtrohet në bazë të Kushtetutës dhe ligjit dhe asnjëherë ndryshe; ai është i ndarë dhe ushtrohet brenda parametrave kushtetues dhe ligjeve të nxjerra në bazë të kushtetutës. Këto u diskutuan më sipër.

E veçanta e organizimit të pushtetit kosovar, ndërkaq, lidhet me rolin e ri kushtetues të këtij pushteti me individin dhe me diversitetin etnik, gjuhësor, fetar, gjinor si dhe me çdo diversitet tjetër të mundshëm. Kjo ka të bëjë me aspektin horizontal të raportit të pushtetit me individin. Në aspektin vertikal, ndërkaq,

---

[203] Për rastet e **Shqipërisë**, të **Polonisë**, të **Hungarisë**, si dhe për ngjashmëritë dhe për dallimet me vendet e tjera ish-komuniste, si dhe për ndikimin në këto vende të përvojës spanjolle, Cf. më shumë në: Scott N. Carlson, "The Drafting Process for the 1998 Albanian Constitution"; Andreë Arato and Zoltan Miklosi, "Constitution Making and Transitional Politics in Hungary"; Lech Garlicki and Zofia A. Garlicka, "Constitution Making, Peace Building, and National Reconciliation: The Expërience of Poland"; Andrea Bonime-Blanc, "Constitution Making and Democratization: The Spanish Paradigm"; dhe Laurel E. Miller, "Designing Constitution-Making Processes: Lessons from the Past, Questions for the Future". Të gjitha këto shkrime janë botuar në Laurlel E. Miller (ed.), *Framing the State in Times of Transition. Case Studies in Constitution Making* (United States Institute of Peace Press: Washington D.C., 2010); cf. po ashtu edhe Christos L. Rozakis, "The European Judge as Comparatist". Në Sir Basil Markesinis & Jorg Fedtke, *Judicial recourse to Foreign Law. A New Source or Inspiration?* (Routledge: London and New York, 2006), pp. 338-339.

[204] Në rastin e **Afrikës së Jugut**, ta zëmë, seksioni 39 (1) (b) dhe (c) i Kushtetutës së vitit 1996 (e cila ende është në fuqi) përcakton që gjykatat vendore "mund të marrin në konsideratë të drejtën e huaj", mirëpo ato "duhet të marrin parasysh të drejtën ndërkombëtare", kur interpretojnë Kartën mbi të Drejtat e Njeriut. Cf., më shumë për këtë dhe për zgjidhjet e ngjashme, në: Dinah Shelton, "International Law and Domestic Legal Systems: Introduction". Në Dinah Shelton*, International Law and Domestic Legal Systems,* fq. 2; Sir Basil Markesinis & Jorg Fedtke, *Judicial Recourse to Foreign Law,* fq. 6 (fusnota nr. 14) fq. 85- 108.

[205] Ernest Barker (ed.), *The Politics of Aristotle*, fq. 97-98.

[206] Për një shtjellim origjinal dhe të gjerë të identiteti kushtetues, të përbërësve të tij, si dhe të vetë historikut të këtij fenomeni, Cf. më shumë Gary Jeffrey Jacobson, *Constitutional Identity*.

Kosova nuk dallon nga vendet tjera të demokracive kushtetuese liberale që dikur i kanë takuar universit komunist në **Evropë**. Kosova, megjithatë, me negociatat e **Brukselit** të vitit 2013 e këndej, si dhe me lidhjen e marrëveshjes për themelimin e një asociacioni të komunave me shumicë serbe në vitin e njëjtë, ka gjasa të mëdha që mund t'i tejkalojë parametrat e standardeve evropiane mbi vetëqeverisjen lokale ashtu siç janë përcaktuar nga Kushtetuta e vitit 2008 dhe **Plani Ahtisari**[207]. Një gjë të tillë e ka konfirmuar Gjykata me aktgjykimin e saj të datës 23 dhjetor 2015, lidhur me asociacionin e komunave me shumicë serbe.[208]

Në aspektin vertikal **Kosova** rrezaton një veçori të theksuar që ka të bëjë me rolin e individit dhe me kultivimin e promovimin e diversitetit etnik, fetar, gjuhësor dhe tjetër që ekziston. Si dëshmi për këtë qëndrojnë dy kapitujt e ndarë, pra dy kapituj me dispozita kushtetuese që në mënyrë të qartë normojnë liritë dhe të drejtat individuale dhe ato që kanë të bëjnë me diversitetin specifik etnik, gjuhësor, kulturor, fetar dhe tjetër të shoqërisë kosovare. Kjo është trashëgimi nga **Plani Ahtisari**. Këtë e kemi sqaruar më sipër gjerësisht. Kjo trashëgimi ka nisur, në fakt, me **Marrëveshjen e Rambujesë** dhe më pastaj përmes **Kornizës Kushtetuese** është bartur në kapitullin e dytë dhe të tretë të Kushtetutës së vitti 2008.

Dispozitat e kapitujve dy dhe tre të Kushtetutës, të marra së bashku, strehojnë identitetin kushtetues të Kosovës, vetë **ADN**-në e saj. Ky identitet është krejt i ndryshëm nga identiteti kushtetues i Kosovës para 10 qershorit 1999. Nëse merret parasysh struktura materiale e shoqërisë aktuale kosovare, identiteti kushtetues i **Kosovës** është krejt i kundërt me identitetin kulturor të vendit. Kjo për faktin se dizajni kushtetues kosovar përmes këtyre dy kapitujve e ngrit dinjitetin e njeriut si bazë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të individit dhe të bashkësisë së cilës i takon. Këtë cilësi të dinjitetit të njeriut, si një vlerë e shtuar me rëndësi praktike, të cilën duhet pasur parasysh çdoherë, e ka afirmuar Gjykata Kushtetuese mjaft herët.[209] Ky lloj pozicioni lidhur me identitetin kushtetues kosovar pasqyron diçka që gjetiu ka ekzistuar mbi gjysmë shekulli më parë. E kemi fjalën për praktikën e **Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë**, e cila njihet me emrin **objektive Wertordnung** ("rend objektiv i vlerave").[210]

Ky rend objektiv i vlerave, sipas modelit nga praktika gjermane, në sistemin kushtetues kosovar imponon një detyrim të pashkruar që thotë se çdo interpretim i Kushtetutës duhet të bëhet në një mënyrë unifikuese dhe të integruar.[211] Ky detyrim çon më tutje historinë kushtetuese, duke e thelluar ndërprerjen e çdo tradite me të kaluarën e hidhur të Kosovës, përkatësisht duke larguar vendin sa më shumë nga

---

207 Më datën 19 prill 2013 është arritur *Marrëveshja mbi Parimet që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Republikës së Serbisë*. Kjo marrëveshje është ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës më datën 27 qershor 2013 me Ligjin nr 04/L-199. Në vijim të vënies në jetë të kësaj marrëveshjeje janë lidhur disa marrëveshje të tjera dhe nxjerrë disa ligje e akte tjera juridike të organeve të Kosovës. Në mesin e këtyre është edhe *Marrëveshja mbi Parimet e Përgjithshme të Asociiacionit të Komunave me Shumicë Serbe*, e lidhur në Bruksel më datën 25 gusht 2015.

208 *Aktgjykim në rastin nr. K0 130/15. Parashtrues: Presidentja e Republikes se Kosovës lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar "Asociacioni / Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosove - Parimet e përgjithshme / Elementet kryesore " me frymën e Kushtetutës, me nenin 3 ["Barazia para Ligjit"], paragrafi 1, me Kapitullin II ["Te Drejtat dhe Lirite Themelore"] dhe me Kapitullin III ["Te Drejtat e Komuniteteve dhe Pjestarëve te tyre"] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës*. Prishtine, 23 dhjetor 2015 Nr. ref.: AGJ 877/15; Për këtë aktgjykim të Gjykatës, origjinën e dialogut dhe dokumentet e prodhuara nga ky dialog deri më sot, kritikën e tyre dhe gjërat tjera që kanë të bëjnë me dialogun Kosovë-Serbi, cf. më shumë në Enver Hasani, "The case of the Serb Association before the Constitutional Court of Kosovo", fq. 493-518.

209 Cf. në veçanti paragrafët 26 dhe 30 të *Aktgjykimit të 18 marsit 2010 të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në Rastin KO 01/09, Cemailj Kurtisi dhe Kuvendi Komunal i Prizrenit,* të cilët, duke cituar **Planin Ahtisari** si bazë legale për Kushtetutën e Kosovës, vërtetojnë **inter alia** se dy dokumentet kanë për qëllim mbrojtjen e dinjitetit, të barazisë, si dhe natyrën multietnike dhe diverse të shoqërisë kosovare.

210 Për një analizë elokuente të këtyre segmenteve, që kanë të bëjnë me renditjen e vlerave në sistemin kushtetues gjerman, Cf. më shumë në: Sir Basil Markensis & Jorg Fedtke, *Judicial Recourse to Foreign Law. A New Source or Inspiration*?, fq. 16-17; 71-82. Në fakt, ky rend objektiv i vlerave mbron vlerat që nuk mund të ndryshohen në asnjë rrethanë nëpërmjet amendamenteve kushtetuese, sepse një gjë e tillë do të paraqiste ndryshim në identitetin kushtetues të shoqërisë së dhënë.

211 Si i tillë, ky koncept që sheh tekstin kushtetues si një dhe të integruar, buron nga përvoja gjermane. Cf. më shumë në: Donald P. Kommers, "German Constitutionalism: A Prolegomenon". *Emory Law Journal,* Vol. 40, Issue 1 (Summer, 1991); Donald P. Kommers, *The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany*. Second Edition (Duke University Press: Durham and London, 1997) fq. 3-60.

sfidimet që vijnë nga identiteti i saj i kaluar.[212] Interpretimi unifikues dhe i integruar në kontekstin kosovar nënkupton se duhen pasur çdoherë parasysh dispozitat tjera të Kushtetutës, krahas atyre nga kapitulli dy dhe tre, siç janë dispozitat që kanë të bëjnë organizimin e pushtetit dhe përfaqësimin e diversitetit kosovar në të gjitha organet e pushtetit politik si dhe dispozitat që detyrojnë marrjen parasysh të vullnetit divers të të gjithëve në Kosovë me rastin e shprehjes së këtij vullneti në çështjet kushtetuese dhe ligjore. Këtu e kemi fjalën për dispozitat kushtetuese lidhur me amendamentet kushtetuese dhe ligjet që prekin interesat vitale të diversitetit kosovar, me dispozitat mbi votat e dy të tretave të bashkësive jo shumicë për ndryshimin e Kushtetutës, krahas dy të tretave të shumicës së deputetëve, pastaj për ato dispozita që kanë të bëjnë me detyrimin për një përfaqësim kushtetues të detyrueshëm të bashkësive jo shumicë në të gjitha organet e pushtetit politik dhe kështu me radhë.

Në këtë largim nga e kaluara dhe sfidat e identitetit të Kosovës nga e kaluara, një rol të madh ka luajtur dhe luan gjyqësia kushtetuese: nëpërmjet mekanizmit të saj institucional, Gjykata Kushtetuese ka prodhuar një jurisprudencë që është për lakmi dhe që i kalon gjykatat e tjera të vendeve ish-komuniste. Kjo ka ndodhur si rezultat i juridiksioni nga neni 113.7 të Kushtetutës me të cilin rregullohet e drejta për ankesë individuale të individëve (dhe të personave juridikë) në rastet kur çmojnë se me akt individual të ndonjë autoriteti publik në Kosovë u janë cenuar drejtat apo liritë e garantuara me Kushtetutë. Ky nen i jep kuptim kartës kosovare për të drejtat e njeriut, që mishërohet në kapitujt dy dhe tre të kushtetutës. Ankesa kushtetuese nga neni 113.7 është e **tipit të plotë** dhe i vë në jetë dispozitat e kapitujve në fjalë për liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të komuniteteve në Kosovë.[213] Se kjo është kështu, shihet nga fakti se Gjykata Kushtetuese, falë kësaj dispozite, duhet të merret në pjesën më të madhe me rastet e **ankesave individuale**: mbi 90 për qind e rasteve të parashtruara në gjykatë, të nisura nga personat fizikë dhe juridikë në **Kosovë**, kanë të bëjnë me ankesa për cenim të të drejtave nga këta dy kapituj.[214]

Interpretimi që GKRKS i bën Kushtetutës, bazohet jo në strukturën materiale të shoqërisë kosovare, por në nenin 53 ["Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut"] të Kushtetutës, i cili përcakton se "të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut". Kjo më tutje nënkupton se parimet, vlerat, normat dhe premisat që përmbajnë kapitujt dy dhe tre, janë efekt refleksiv i karakteristikave themelore të konstitucionalizmit modern perëndimor ku synon të ankorohet thellë identiteti i ri kushtetues kosovar. Kur Gjykata interpreton dispozitat e këtyre dy kapitujve, këtë e bën krejt në mënyrë të pavarur nga ndërgjegjja morale e aktorëve lokalë kosovarë dhe nga vetë struktura materiale

---

212 Për rastet e tundimeve gjatë kushtetutëbërjes për zgjedhjen ndërmjet të së kaluarës së mirë dhe të së ardhmes së pasigurt, Cf. më shumë në shkrimin e Alexander H. E. Morawa, "Kafka, Kelsen and Supremacy: How European Courts Could Inteact with a Vieë to Fostering Constitutionalism". Në Kyriaki Topidi and Alexander H. E. Moraëa (eds.), *Constitutional Evolution in Central and Eastern Europe,* fq. 159-205.

213 Ky emër buron nga **jurisprudenca gjermane** dhe ka të bëjë me faktin sipas të cilit Gjykata mund të vendosë si aspektet faktike ashtu dhe ato juridike të rastit konkret. Në këto sisteme, të cilit i takon edhe **Kosova**, gjykatat kushtetuese konsiderohen si vende ku gjenden mjetet efektive juridike para se të shkohet në **GJEDNJ**. Kjo është kështu sepse gjykatat kushtetuese në këto sisteme kanë të drejtën e prishjes së vendimeve përfundimtare të gjykatave të rregullta dhe të vendimeve të institucioneve të tjera publike dhe t'i rikthejnë prapa tek vendimmarrësi për shqyrtim të sërishëm në dritën e lëshimeve të gjetura nga gjykata kushtetuese përkatëse. Burimi i kundërkushtetutshmërisë mund të jetë faktik dhe i natyrës juridike. Për këtë kemi diktuar në kapitujt e mëhershëm. Cf. më shumë për këtë edhe në: European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), *Study on Individual Access to Constitutional Justice* (CoE: Strasbourg 2009). Study No. 538/2009 Adopted by the Venice Commission at its 85th Plenary Session (Venice, 17-18 December 2010).

214 Ky aspekt i punës së gjykatave kushtetuese në lëmin e të drejtave të njeriut është cilësuar si "procesi i juridifikimit të diskursit mbi të drejtat e njeriut". Cf. më shumë për këtë në: Tom Campbell, K.D. Eëing, and Adams Tomkins, "Introduction". Në Tom Campbell, K.D. Ewing, and Adams Tomkins, *The Legal Protection of Human Rights. Skeptical Essays* (Oxford University Press: Oxford, 2011), fq. 1-10; Janet L. Hiebert, "Governing Like Judges?". Në Tom Campbell, K.D. Ewing, and Adams Tomkins, *The Legal Protection of Human Rights. Skeptical Essays,* fq. 40-65. Punimet e tjera të këtij vëllimi shprehin qëndrim të njëjtë, përkatësisht se mbrojtja e të drejtave të njeriut kërkon më shumë diskutim mbi aspektet e tyre politike, sociale e kulturore sesa diskutim mbi konstruksionin juridik, të cilin ata e quajnë "juridifikim", për ta dalluar nga "politizimi" që ndodh në kuadër të trupave politike dhe reprezentative që kanë një natyrë deliberative (siç janë: parlamentet, këshillat, shoqëria civile, dhe ngjashëm me këto).

e shoqërisë, duke u bazuar vetëm në urdhrin detyrues si më sipër nga neni 53 i Kushtetutës.[215] E përkthyer në terma të **BE**-së dhe identitetit të vendeve anëtare sipas interpretimit që **Gjykata Evropiane e Drejtësisë (GJED)** ia bën në praktikë **Marrëveshjes për BE**-në (2007), atëherë kjo nënkupton se GJKRKS në mënyrë të njëjtë me të ndjek rrugën e forcimit të identitetit kushtetues kosovar kundrejt identitetit nacional të komuniteteve kosovare. U mor vesh, ajo e bën këtë me një kuptim dhe për arsye krejtësisht të tjera nga ato që vlejnë në jurisprudencën e **GJED**: në rastin e Kosovës, GJKRKS ka për synim rikrijimin dhe ridefinimin e një identiteti nacional duke pasur për pikë referimi kushtetutën nacionale, jo strukturën materiale të shoqërisë, kurse, në rastin e BE-së, GJED një balancim të identiteteve nacionale me identitetin e skicuar në nenin 4.2 të **Marrëveshjes për BE-në** (2007).[216]

Se kjo është kështu shihet jo vetëm nga krahasimi i strukturës së këtij neni dhe e nenit 113.7 të Kushtetutës, por edhe nga dispozitat e tjera kushtetuese, të cilat flasin për juridiksionin e GJKRKS. Modeli i drejtësisë kushtetuese kosovare, i përcaktuar me dispozitat kushtetuese mbi juridiksionin, i jep kësaj të fundit një rol dhe pozitë të fortë në sistemin kushtetues kosovar. Këto janë çështje, të cilat diskutohen në kapitujt në vijim.

Asnjë kuptim nuk do të kishte kjo që u tha më sipër, sikur të mungonte trajtimi i juridiksionit të Gjykatës, i modelit evropian/kelsenian të gjyqësisë kushtetuese që kultivohet nga ajo. Vetëm të kuptuarit analitik të këtij juridiksioni na jep pasqyrën e qartë të keqkuptimeve ekzistuese në diskursin publik kosovar rreth problemeve kryesore të së drejtës kushtetuese në vend. Keqkuptimi kundrejt rolit dhe rëndësisë së Gjykatës Kushtetuese, në **Kosovë** vihet në sprovë thuajse çdoherë pas ndonjë **vendimi të madh** të këtij institucioni. Ky keqkuptim buron, në rend të parë, nga fakti i mosnjohjes elementare të caqeve si dhe të vetë natyrës së juridiksionit të **Gjykatës Kushtetuese**, gjë e cila lidhet me cilësinë dhe llojin e studimeve të drejtësisë në të kaluarën e Kosovës.[217]

Çështjet e juridiksionit të gjykatës dhe llojet e tij trajtohen në kapitujt në vijim, atëherë kur të flasim për juridiksionin e gjyqësinë kushtetuese kosovare. Mjafton të theksohet këtu se ky juridiksion reflekton veçorinë më të theksuar të dizajnit kushtetues kosovar: në kuadër të juridiksionit nga neni 113 i Kushtetutës gjenden të gjitha llojet e juridiksionit klasik të modelit **evropian/kelsenian.** Në këtë kuadër, megjithatë, ekzistojnë edhe disa specifika jo-standarde për gjyqësinë kushtetuese, siç janë ato që kanë të bëjnë me **kontrollin kushtetues të amendamenteve kushtetuese** dhe **kontrollin kushtetues të konvencionalitetit**, përkatësisht me kontrollin nëse ndonjë amendament kushtetues është në kundërshtim me detyrimet ndërkombëtare të **Kosovës** të marra përsipër në mënyrë kontraktuale.[218] Në kategorinë

---

215 Cf. më shumë për këtë aspekt në: Thomas Risse and Kathryn Sikknik, "The Socialization of International Human Rights Norms Into Domestic Practices: Introduction", fq. 17.

216 Article 4.2 ["Common Provisions"] of the Treaty on European Union: "[…] 2. The Union shall respect the equality of Member States before the Treaties as ëell as their national identities, inherent in their fundamental structures, political and constitutional, inclusive of regional and local self-government. It shall respect their essential State functions, including ensuring the territorial integrity of the State, maintaining law and order and safeguarding national security. In particular, national security remains the sole responsibility of each Member State."; Për komente interesante, të kundërta me praktikën e **GJED** dhe që shkojnë kundër interpretimit gjyqësor të identitetit evropian, cf. më shumë në Pietro Faraguna, "A Living Constitutional Identity: The Contribution of Non-Judicial Actors". *Jean Monnet Working Paper* 10/15 (NYU School of Law: New York, NY, 2015).

217 Keqkuptime nga autorët e huaj, të ngjashme me ato të segmenteve të caktuara të juristëve kosovarë që i diskutojmë në kapitullin në vijim, i kemi hasur vetëm në një shkrim. Sado që autori i këtij shkrimi synon një status prej studiuesi analitik të punës së **Gjykatës Kushtetuese në Kosovë**, një qëllim i tillë gjendet larg arritjes. Kjo, jo për faktin se autori i shkrimit është ekonomist me profesion, pa asnjë bagazh serioz akademik, por, mbi të gjitha, për arsye se analiza në fjalë përmban mungesë të njohurive themelore për formën dhe për përmbajtjen e juridiksionit kushtetues kosovar (natyra e modelit kushtetues kosovar). Cf. Andrea Lorenzo Capussela, "A Critique of Kosovo's Internationalized Constitutional Court." *European Diversity and Autonomy Papërs* (EDAP:02/2014). Në internet: www.eurac.edu/edap.

218 Neni 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës:
" […] 2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:
(4) përputhshmëria e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, të ratifikuara sipas kësaj Kushtetute dhe rishikimi i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur; […].."; Për analizë komparative të kontroillit të konvencionalitetit, cf. më shumë në Mr Igor SPIROVSKI, *"THE COMPETENCE OF THE CONSTITUTIONAL COURT TO CONTROL THE CONFORMITY OF LAWS WITH INTERNATIONAL TREATIES: NEW TRENDS IN CONSTITUTIONAL JUSTICE*". EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION) in co-opwration with THE CONSTITUTIONAL COURT OF MONTENEGRO AND THE OSCE. (Report). CDL-JU(2009) 036 (Engl. only). Strasbourg, 17 November 2009. Në internet: http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx? pdffile =CDL-JU(2009)036-e (shi-9kuar në janar 2018).

e detyrimeve kontraktuale hyjnë edhe ato detyrime që **Kosova** i ka marrë njëanshëm, siç është zotimi i marrë nga **Kosova**, përmes **Deklaratës mbi Pavarësinë,** për të zbatuar ligjin ndërkombëtar, si dhe zotimi tjetër, po ashtu i njëanshëm, i cili figuron në Kushtetutë, në nenin 22 ["Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare"].

Ky nen numëron një nga një instrumentet dhe marrëveshjet ndërkombëtare që zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në **Kosovë**. Këto detyrime dhe këto zotime, të cilat Gjykata Kushtetuese i merr si bazë të vendimmarrjes së saj sepse janë burim i së drejtës kushtetuese, ekzistojnë krahas dhe në paralel me detyrimet ndërkombëtar nga neni 19 ["Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare"] i Kushtetutës, i cili normon zbatimin e detyrimeve të vlefshme kontraktuale dhe të drejtës së përgjithshme ndërkombëtare.[219] Dallimi në mes të detyrimeve kushtetuese nga neni 22 dhe atyre të marra përsipër nga ana e Kosovës sipas nenit 19 të Kushtetutës konsiston në atë se të para janë detyrime të pastra kushtetuese, kurse të dytat janë detyrime ligjore, me fuqi juridike më të ulët se Kushtetuta. Mbi bazën e këtij zotimi bilateral nga neni 19 i Kushtetutës, të marrë nga **Kosova** në mënyrë vullnetare, sot ekziston efektivisht një gjykatë e ndarë kushtetuese me seli në **Hagë**. E kemi fjalën për **Gjykatën Speciale**, e cila është themeluar në bazë të **amendamentit kushtetues nr. 24**, që sot është bërë neni 162 i Kushtetutës së vitit 2008. Siç u theksua më sipër në seksionin 10.3 të këtij kapitulli, ky amendament ka hyrë në fuqi më datën 3 gusht 2015, kur është miratuar në **Kuvend të Kosovës**. Me te është parashikuar themelimi i **Gjykatës Speciale**, e cila ngërthen tri lloje të kompetencave:

- gjykimin penal në të gjitha shkallët;
- zyrën e prokurorit special; dhe, së fundi,
- gjykimin për çështjet kushtetuese që kanë të bëjnë me punën e dhomave të kësaj gjykate.

Si një lloj i ndërmjetëm është edhe **institucioni i ombudspersonit**, i themeluar vetëm për rastet e të drejtave dhe lirive të njeriut në procedurat pranë apo lidhur me **Gjykatën Speciale.**

Në literaturë pohohet se amendamenti nr. **24** përbën bazën juridike **ad hoc** për ndryshimin e sistemit gjyqësor në Kosovë.[220] Kjo nuk është e saktë. Me amendamentin në fjalë nuk ka ardhur deri të ndryshimi i sistemit gjyqësor kosovar si pasojë e krijimit të bazës së re juridiko-kushtetuese për themelimin e një mekanizmi gjyqësor me juridiksion të specializuar. Ky mekanizëm është ndërtuar dhe vazhdon të ekzistojë brenda sistemit gjyqësor ekzistues të Kosovës, konform nenit 4.5 lidhur me nenin 103.7 të Kushtetutës. Një gjë e tillë qartë konstatohet në Aktgjykimin e GJKRKS në rastin **KO 26/15**.[221] Me këtë rast, Gjykata nuk ka marrë për bazë vetëm parametrat nga kapitulli i dytë i Kushtetutës, por ka analizuar deri në hollësi nëse formimi i këtij mekanizmi prish rendin kushtetues dhe sistemin aktual të drejtësisë kosovare.[222] Nuk është e saktë, pra, kur thuhet në literaturë se Gjykata Kushtetuese ka kryer vetëm kontrollin kushtetues sipas parametrave të nga kapitulli i dytë i Kushtetutës, duke lënë anash kontrollin kushtetues me qëllim të vërtetimit nëse formimi i kësaj gjykate prish rendin kushtetues dhe sistemin e përgjithshëm të drejtësisë në Kosovë.[223] Gjykata Kushtetuese ka diskutuar gjerësisht parametrat kushtetues nga kapitulli i dytë dhe i tretë, germën dhe frymën e Kushtetutës, si dhe aspektin e unitetit të rendit kushtetues dhe sistemit të përgjithshëm të drejtësisë në Kosovë.

Nga analiza e bazuar në këta parametra, Gjykata ka thënë se formimi i **Gjykatës Speciale** nuk mund të jetë anti-kushtetues, sikundër që as operimi i saj nuk do të ndodhë në një ambient **ekstra-kushtetues** (siç e thuhet në mënyrë të gabuar).[224] Kjo është kështu për shkak të faktit se amendamenti nr. **24** e ka bërë të qartë se mekanizmi në fjalë do

---

219 Neni 19 ["Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare"] i Kushtetutës:
"1. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi të botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji.
2. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës."

220 Fisnik Korenica, Argjend Zhubi, Dren Doli, ".The EU-engineered hybrid and international specialist court in Kosovo: How 'special' is it? fq. 481.

221 Cf. fusnota nr. **153**, **supra**, si dhe komentet tona aty

222 Cf. Aktgjykimi në rastin KO 26/15, paragrafet:

223 Fisnik Korenica, Argjend Zhubi, Dren Doli, ".The EU-engineered hybrid and international specialist court in Kosovo: How 'special' is it?, fq. 482.

224 Ibid. fq. 482.

të themelohet për të gjitha nivelet e gjyqësorit kosovar, mirëpo do të funksionojë gjithnjë në kuadër të juridiksionit të specializuar dhe juridikisht të përcaktuar në mënyrë të saktë, përfshirë këtu juridiksionin e tij në çështjet kushtetuese. Organizimi dhe juridiksioni i saj i specializuar, ndërkaq, sipas redaktimit të amendamentit nr. **24,** përcaktohet me ligj. Në këtë frymë ka ardhur deri te nxjerrja e **Ligjit Nr. 05/L -053.**[225]

Kushtetutshmërinë e këtij hapi të sovranit të përfaqësuesit të Kosovës, që votoi me dy të tretat amendamentin nr. **24**, duke krijuar kështu bazën kushtetuese konform neneve 4.5 dhe nenit 103.7 të Kushtetutës, **GJKRKS** e ka vlerësuar edhe nga këndvështrimi i sovranitetit të **Shtetit të Kosovës.**[226] Nga kjo lehtë mund të konkludohet se amendamenti nr. **24** nuk përbën një regjim juridik ekstra-kushtetues që rregullon juridiksionin e specializuar nga neni 103.7 i Kushtetutës në mënyrë të pavarur nga normat tjera kushtetuese.

Si çdo amendament, edhe amendamenti nr. **24** ka hyrë në fuqi në momentin e votimit të tij në Kuvend. Ai ka të njëjtën fuqi sikur çdo normë tjetër kushtetuese, pa marrë parasysh kur e ka votuar përfaqësuesi i sovranit të Kosovës.[227] Parametrat për vlerësim të kushtetutshmërisë së një amendamenti kushtetues, sikundër dihet, gjenden në vetë normat dhe parimet kushtetuese në fuqi: një draft i një norme kushtetuese, ende pa hyrë në fuqi, vlerësohet në aspektin e kushtetutshmërisë, duke u bazuar në parametrat e normave dhe parimeve kushtetuese që janë në fuqi. Shikuar nga aspekti logjik gjuhësor, kjo sikur tingëllon si një paradoks sepse këtu bëhet vlerësimi i kushtetutshmërisë së një norme që ende nuk ekziston, që ende nuk është në fuqi, duke marrë për bazë parametrat kushtetues që gjenden në normat dhe parimet kushtetuese në fuqi. Jo pa arsye, procedurat e kontrollit të kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese, në literaturë janë cilësuar si paradoks i konstitucionalizmit modern. Siç e kemi thënë, **Kosova** hyn në grupin e shteteve të rralla që parashikojnë këtë procedurë të kontrollit kushtetues, këtë **paradoks kushtetues**, ku normat kushtetuese që ende janë në draft vlerësohen në aspektin e kushtetutshmërisë së tyre, duke marrë si parametër matës normat kushtetuese pozitive.[228]

Subjektiviteti juridik i **Gjykatës Speciale** është i kufizuar vetëm sa i përket ushtrimit të funksionit dhe mandatit të vet: marrëveshjet ndërkombëtare dhe detyrimet tjera nga neni 18 i Kushtetutës ngelin në vullnetin e Kosovës dhe, për arritjen e tyre, kërkohet pëlqim i Kuvendit. Thënë me fjalë tjera, **Gjykata Speciale** nuk ka zotësi juridike për marrëveshjet nga neni 18 i Kushtetutës që pasqyrojnë sovranitetin e Kosovës me jashtë.[229] Ky pozicion reflektohet në nenin 5 të **Ligjit Nr. 05/L -053** dhe i takon domenit të së **drejtës ndërkombëtare zakonore**. Për aspektet tjera të gjyqësisë kushtetuese brenda **Gjykatës Speciale**, si dhe për anët tjera të organizimit dhe punës së këtij mekanizmi do të diskutojmë më shumë në seksionin 11. 2 të kapitullit 11 të këtij libri.

10.5. Komente dhe pyetje

10.5.1. Në aspektin kushtetues kanë ekzistuar disa Jugosllavia. Në aspektin e të drejtës ndërkombëtare, ndërkaq, njihen vetëm dy: e para është ish-Jugosllavia, e krijuar në dhjetor të vitit 1918 dhe e

---

225 **Ligji Nr. 05/L -053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar**, datë 3 gusht 2015. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*. Nr. 20. Prishtinë: datë 5 gusht 2015.

226 Aktgjykimi në rastin KO 26/15, paragrafët si vijon:
"71. Sa i përket amendamentit të nenit 162, paragrafi 1, të Kushtetutës, Gjykata vëren se krijimi i katër elementeve strukturore në kuadër të sistemit të drejtësisë buron nga sovraniteti i Republikës së Kosovës, ku Kuvendi, me shumicën e dy të tretave, miratoi Ligjin nr. 04/L-274. Kjo është në pajtueshmëri me nenin 103, paragrafi 7, dhe me nenin 31 të Kushtetutës, sepse këto elemente të reja strukturore në sistemin e drejtësisë të Kosovës bëhen me ligj dhe me qellim të luftimit të krimeve specifike, të cilat në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-se kërkojnë masa, procedura dhe institucione të karakterit të specializuar.
72. Prandaj, Gjykata konfirmon se paragrafi 1 i amendamentit të propozuar nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës."

227 Aktgjykimi në rastin KO **26/15**, paragrafi 103:
"Sa i përket hyrjes në fuqi të amendamentit nr. 24, Gjykata vëren se, teksti nën numrin romak II, që rregullon atë, është identik me nenin 144, paragrafi 4, të Kushtetutës, ku thuhet:
"Ndryshimet e Kushtetutës hyjnë në fuqi menjëherë pas miratimit të tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës". […]"

228 Cf. më shumë për këtë komentet tona si dhe literaturën e përdorur për trajtimin e teorisë dhe praktikës së amendamenteve jokushtetuese, në seksionet 11.3 dhe 11.3.9 të kapitullit 11 ku kemi sqaruar teorinë dhe praktikën e amendamenteve jokushtetuese dhe kontrollin e kushtetutshmërisë së tyre ndër ne dhe nëpër botë.

229 Për interpretim të gabuar të nenit 4.4 ["Përsonaliteti dhe zotësia juridike"] të **Ligjit Nr. 05/L -053**, cf. Fisnik Korenica, Argjend Zhubi, Dren Doli, "The EU-engineered hybrid and international specialist court in Kosovo: How 'special' is it?, fq. 483-484.

shpërbërë tërësisht në prill të vitit 1992, kurse e dyta është **RFJ**, krijesa e krijuar nga diktatori serb **S. Millosheviq** në pranverë të vitit 1992 dhe e riemërtuar në **USMZ** në vitin 2003. Ky shtet, pra **RFJ**, ka qenë njëri prej pesë shteteve të dala nga shpërbërja e ish-**Jugosllavisë**. Kjo do të thotë se Kosova ka qenë pashmangshëm pjesë e zhvillimit politik dhe kushtetues të ish-**Jugosllavisë** dhe **RFJ**, si shtete ndërkombëtarisht të njohura. Në këtë të fundit, **Kosova** ka qenë vetëm deri në qershor të vitit 1999: me hyrjen e trupave të **NATO**-s në vend ka ardhur deri te suspendimi i sovranitetit serb, suspendim që ka zgjatur deri me lindjen e **Kosovës** si shtet sovran dhe i pavarur më 17 shkurt të vitit 2008. A ka pasur gjyqësi kushtetuese në kohën e Jugosllavisë mbretërore? Nëse jo, pse?

10.5.2. Në aspektin e gjyqësisë kushtetuese, sigurisht që nuk mund të bëhet fjalë për asgjë konkrete në kohën sa ka qenë në fuqi **Kushtetuta e Jugosllavisë** e vitit 1931. Pushteti i kurorës serbe ngelej i paprekur dhe nuk i nënshtrohej asnjë kontrolli nga jashtë, kurse neni 116 i Kushtetutës përbënte një kërcënim në hije për të gjithë ata që mëtonin kufizimin e kontrollit absolut të mbretit. Si pjesë e këtij koncepti, që binte ndesh me natyrën dhe funksionin parësor të gjyqësisë kushtetuese, ishte edhe fakti se vetë ajo ka qenë një kushtetutë e dhuruar. Diskutoni!

10.5.3. Sipas Kushtetutës së **RFPJ** (1946), si organ kryesor i pushtetit lajmërohet **Kuvendi Federativ**, i përbërë nga dy dhoma, kurse vetë pushteti nuk ishte i ndarë, por unik. Parimi i unitetit të pushtetit ishte kategori kushtetuese, jo vetëm ideologjike, dhe përbënte premisën bazë dhe përcaktuese lidhur me origjinën dhe natyrën e pushtetit. A mund të bëhet fjalë, në këtë kontekst, për ndonjë kontroll gjyqësor të kushtetutshmërisë së ligjeve?

10.5.4. Në këtë kohë, megjithatë, shfaqen shenjat e para të institutit të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjera juridike, njëjtë si në ish-**BRSS.** Çfarë natyre ka pasur kontrolli i kushtetutshmërisë sipas **Kushtetutës së RFPJ** dhe cili organ ka kryer një kontroll të tillë?

10.5.5. Në aspektin e gjyqësisë kushtetuese, ish-**Jugosllavia** përbën shtetin e katërt në **Evropë** e të parin në botë nga shtete komuniste që ka futur në përdorim gjyqësinë kushtetuese. Kjo gjyqësi kushtetuese ka qenë si në nivel qendror federal, ku **Gjykata Kushtetuese e RSFJ** ka ushtruar këtë lloj të gjyqësisë, kurse në nivel të republikave dhe krahinës së Vojvodinës një gjë të tillë e kanë ushtruar gjykatat e tyre kushtetuese. Ky nuk ka qenë rasti me **Kosovën** (sic!). Diskutoni arsyet pse kjo është kështu?

10.5.6. Kur është themeluar **GJKKSAK** dhe në cilat rrethane dhe për cilat shkaqe?

10.5.7. Para se të themelohej GJKKSAK, në vend ka ekzistuar një formë gjyqësore e kontrollit të kushtetutshmërisë. Cili organ kosovar ka pasur kompetencë për të vendosur lidhur me çështjet kushtetuese në kuadër të sistemit gjyqësor kosovar para themelimit të **GJKKSAK**?

10.5.8. Juridiksioni dhe palët e autorizuara për t'u paraqitur pranë **Degës Kushtetuese** kanë qenë të ngjashme me ato që kanë pasur gjykatat kushtetuese republikane, **Gjykata Kushtetuese e RSFJ** dhe, më vonë, nga viti 1972, edhe vetë **GJKKSAK.** Cili ka qenë juridiksioni dhe kush kanë qenë pakët e autorizuara për t'u paraqitur pranë këtij organi kushtetues të KSAK? A ka mundur të vihet në lëvizje vetvetiu?

10.5.9. Në bazë të kësaj **Kushtetutës së RSFJ** të vitit 1974, **Kosova** fiton të drejtën e nxjerrjes së kushtetutës së vetë në mënyrë autonome, njëjtë siç e kishin gëzuar këtë të drejtë ish-republikat jugosllave. **Kosova**, këtë të drejtë e ka realizuar më datën 28 shkurt 1974, kur nxjerr kushtetutën e parë në historinë e saj. Kushtetuta nuk ndryshoi pozitën e **GJKKSAK**, e cila ishte themeluar dy vite më parë.

Fakti se **Kosova** nxjerr kushtetutën e vet, si akt më i lartë politiko-juridik, e zgjeron dukshëm bazën e aktivitetit të GJKKSAK. Tregoni lidhur me cilat çështje ajo kishte juridiksion për të vendosur? Në veçanti tregoni se në çka konsistonte puna e saj në lëmin e a.q. përcjelljes së dukurive me interes për kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë që kishin rëndësi për realizimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në **KSAK**?

10.5.10. Kosova, sipas **Kushtetutës së RSFJ** të vitit 1974, kishte gëzuar një pozitë juridike të gjysmërepublikane, duke pasur kompetenca dhe organe të ngjashme më ato të ish-republikave jugosllave, si në formë ashtu dhe në përmbajtje. Në lëmin e gjyqësisë kushtetuese, përmes **GJKKASAK** ushtronte kontrollin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, njëjtë si republikat ish-jugosllave. Kjo gjendje ndryshoi më 23 mars 1989. Diskutoni se si ka ardhur deri te ky ndryshim dhe cilat kanë qenë pasojat e tij për gjyqësinë kushtetuese kosovare!

10.5.11. Amendamentimi kushtetues në nivel jugosllav, në kundërshtim të hapur me **Kushtetutën e RSFJ** të vitit 1974, ndodhi si reagim ndaj ndryshimeve të dhunshme kushtetuese që ishin kryer në **Kosovë** më datën 23 mars 1989. Kjo nisi me sllovenët dhe u përhap gjithandej nëpër republikat ish-jugosllave. Cila ishte përmbajtja e këtyre amendamentimeve dhe cili ka qenë qëndrimi i **Gjykatës Kushtetuese të RSFJ**?

10.5.12. Kushtetuta e Serbisë e shtatorit të vitit 1990, edhe në aspektin formal abrogon çdo element të autonomisë së Kosovës: tani e tutje, ajo nuk ka asnjë kompetencë kushtetuese dhe ligjvënëse, duke u kthyer kësisoj në gjendjen e viteve 1945-1969, kur dominohej e administrohej **de facto** dhe **de jure** nga regjimi në **Beograd**. Në këtë fazë, nga shtatori i vitit 1990 e deri në vitin 2008, a mund të bëhet fjalë për ndonjë gjyqësi kushtetuese kosovare?

10.5.13. Kushtetuta e Kaçanikut është miratuar nga përbërja e legjislaturës së fundit të **Kuvendit të KSAK**. Në këtë përbërje kanë marrë pjesë vetëm shqiptarët dhe disa prej deputetëve të komuniteteve jo serbe dhe joshqiptare të **Kosovës**. Kuvendi ka vepruar në ilegalitet si pasojë e represionit serb dhe është mbledhur në **Kaçanik** të Kosovës për të miratuar këtë kushtetutë. Kjo ka ndodhur më datën 7 shtator 1990, në paralel me hapat e ngjashëm që i ndërmerrnin republikat ish-jugosllave dhe popujt e tyre në vijim të rezistimit të hegjemonisë serbe. Kjo kushtetutë, megjithatë, asnjëherë nuk është vënë në jetë si pasojë e okupimit të thellë serb në vitet 1990-1999.

Gjyqësia kushtetuese kosovare, sipas **Kushtetutës së Kaçanikut** ka ruajtur disa prej premisave të gjyqësisë së mëhershme kushtetuese, njëjtë siç kishin bërë edhe republikat ish-jugosllave në atë kohë. Kjo shihet qartë nga dispozitat e neneve 128-134 të pjesës së VII ["Organet Republikane"] të Kushtetutës së Kaçanikut. Këto nene normonin juridiksionin dhe palët e autorizuara, zgjedhjen e kryetarit dhe gjyqtarëve, imunitetin, disiplinimin dhe kushtet për shkarkimin e tyre, mënyrën e vendimmarrjes dhe efektin juridik të vendimeve dhe, fare në fund, autonominë e rregullimit të brendshëm të Gjykatës. Diskutoni të gjitha këto aspekte, ashtu siç qenë përcaktuar sipas **Kushtetutës së Kaçanikut**!

10.5.14. A ka mund të vihej në lëvizje me vetëiniciativë (**sua sponte**) Gjykata Kushtetuese e përcaktuar sipas **Kushtetutës** së **Kaçanikut**?

10.5.15. A ka qenë e njohur e drejta për ankesë kushtetuese në **Kushtetutën e Kaçanikut**?

10.5.16. Marrëveshja e Rambujesë ka përcaktuar që **Kosova** të ketë një gjykatë kushtetuese. Njëjtë si në **Marrëveshjen e Dejtonit**, edhe kjo marrëveshje e kishte kushtetutën si shtojcë të saj: **Kushtetuta e Rambujesë** kishte dispozita që flisnin për gjyqësinë kushtetuese kosovare. Cilat janë cilësitë e gjyqësisë kushtetuese sipas **Marrëveshjes së Rambujesë**?

10.5.17. Cili ka qenë juridiksioni i **Gjykatës Kushtetuese** sipas **Kushtetutës së Rambujesë**?

10.5.18. Cilat kanë qenë palët e autorizuara për të vënë në lëvizje **Gjykatën Kushtetuese** sipas **Kushtetutës së Rambujesë**?

10.5.19. Në sferën e e lirive dhe të drejtave të njeriut si dhe të asaj që tani quhen komunitetet e **Kosovës,** me **Kushtetuta e Rambujesë** fillon faza e parë të ndërtimit të identitetit të ri efektiv kushtetues të Kosovës, identitet që aspak nuk përputhet me kulturën materiale të shoqërisë kosovare në të gjitha fazat e zhvillimit të saj në të kaluarën. Çfarë nënkupton kjo dhe si reflektohet në lëmin e gjyqësisë kushtetues kosovare sot?

10.5.20. A ka pasur gjyqësi kushtetuese në kohën e administratës së **UNMIK**-ut nuk ka pasur gjyqësi kushtetuese kosovare? Nëse përgjigja juaj është negative, atëherë tregoni arsyet për një gjë të tillë!

10.5.21. Në lëmin e gjyqësisë kushtetuese, përkundër krejt kufizimeve logjike dhe tërësisht të natyrshme në aspektin juridiko-kushtetues dhe juridiko-ndërkombëtar, **Korniza Kushtetuese** ka ofruar një zgjidhje të çuditshme, unikate dhe krejtësisht kontekstuale e origjinale. Ajo zgjidhje gjendet e ankoruar në stipulimet e pjesës së katërt ["Sistemi Gjyqësor"] të Kornizës. Aty flitej për themelimin e një organi të veçantë për çështjet e Kornizës në kuadër të **Gjykatës Supreme të Kosovës**. Si quhej ai organ? Cilat kanë qenë kompetencat e tij dhe kush kanë qenë palët e autorizuara? A ka qenë ky organ pjesë e gjyqësorit kosovar të kohës apo i ndarë nga ai? A ka qenë realisht ky organ një organ i kontrollit të kushtetutshmërisë, marrë parasysh se supremacia (epërsia) e Rezolutës, jo e Kornizës Kushtetuese, ka qenë postulati themelor i tërë sistemit?

10.5.22. Pas një analize të gjithanshme të situatës dhe të metave si më sipër që lidheshin me ngjarjet tragjike të marsit 2004, si dhe pas dështimit të tërësishëm të strukturave të **UNMIK**-ut dhe të **KFOR**-it për të mbrojtur liritë dhe të drejtat e kosovarëve, **Komisioni i Venecias** prodhoi një raport të shkëlqyer ku propozonte themelimin e një gjykatë për të drejtat e njeriut, me karakter universal dhe të përbërë në shumicë me gjyqtarë ndërkombëtarë. Kush duhet t'i caktonte gjyqtarët e kësaj gjykate, cilat ishin kompetencat e saj dhe palët e autorizuara?

10.5.23. **Gjykata për të Drejtat e Njeriut** nuk u themelua asnjëherë! Pse? Tregoni shkaqet për mosformimin e saj.

10.5.24. Në vend të **Gjykatës për të Drejtat e Njeriut**, si më sipër, u themelua një panel këshilldhënës për të drejtat e njeriut. Kush e dha rekomandimin për themelimin e tij dhe pse u themelua? Kush ishin anëtarë të tij dhe kush i caktonte? Cilat ishin vendimet e tij për nga natyra e tyre juridike? Deri kur ka funksionuar ky panel dhe kush mund të ishin palët në procedurat para tij?

10.5.25. Në lëmin e gjyqësisë kushtetuese, **Plani Ahtisari** në aneksin e parë të tij flet për dispozitat kushtetuese, të cilat patjetër është dashur të reflektohen në kushtetutën e ardhshme të Kosovës. Në kuadër të këtyre dispozitave, Plani ka radhitur Kosovën në mënyrë shumë të qartë në grupin e vendeve me sistem **evropian/kelsenian** të gjyqësisë kushtetuese, duke e përcaktuar vetëm fizionominë bazike përmes ndarjes së saj nga gjyqësori i rregullt dhe duke mos përcaktuar më hollësisht të gjitha kompetencat e këtij institucioni kaq me rëndësi për shtetin e ri të Kosovës. Dy kanë qenë kompetencat që, megjithatë, Plani i ka theksuar shprehimisht. Cilat janë ato kompetenca dhe pse janë përcaktuar në këtë dokument?

10.5.26 Me nxjerrjen amendamentit kushtetues të datës 3 gusht 2013, përkatësisht me nxjerrjen e amendamentit nr. **24** në Kushtetutën e vitit 2008 (tani neni i saj 162), u krijua baza e re kushtetuese për bartjen jashtë Kosovës të juridiksionit të tërësishëm gjyqësor, përfshirë juridiksionin në çështjet kushtetuese. Për çka bëhet fjalë këtu?

10.5.27. Mendimi i **GJND** për **Kosovën** nuk ka ngelur pa u vërejtur dhe pa i hyrë në punë gardianit të Kushtetutës së Kosovës. Në luftën e saj, sipas rregullave të profesionit, për të zënë hapësirën e akterëve ndërkombëtarë, të cilët, duke u bazuar në **Planin Ahtisari**, ende ishin pjesë përbërëse e pavarësisë së mbikëqyrur të Kosovës dhe ushtronin ligjërisht disa nga funksionet që do të duhej t'i ushtronte gjyqësori vendor, **Gjykata Kushtetuese** u mbështet në mendimin e **GJND**-së për **Kosovën**. Ndër funksionet që ende ushtroheshin nga ndërkombëtarët, bënin pjesë disa kompetenca që ushtroheshin nga departamenti që gjykonte çështjet rreth privatizimit në kuadër të **Gjykatës Supreme.** Në aspektin formal, ky departament, duke u bazuar në vetë **Planin Ahtisari**, ishte brenda instancës më të lartë gjyqësore në vend. Sjelljet e këtij departamenti, megjithatë, gjasonin në uzurpim të pushtetit sepse dukshëm tejkalonin mandatin e dhënë me **Planin Ahtisari**, dokumenti mbi bazën e të cilit **Kosova** kishte shpallur pavarësinë. Diskuto se për çfarë bëhet fjalë këtu? Cili vendim i **Gjykatës Kushtetuese** ka përdorur mendimin e **GJND** për Kosovën?

10. 6. Lexim shtesë

- Dimitrije Kulic, "The Constitutional Court of Yugoslavia in the Protection of Basic Human Rights" *Osgoode Hall Law Journal* Vol. 11 No. 2 (August 1973)
- Dimitrije Kulic, "Constitutionality and Constitutional Justice." 22 *Collection Papers Faculty of Law Nis* 45 (1982)
- Kristaq Traja, *Drejtësia Kushtetuese* (Shtëpia Botuese "Luarasi": Tiranë, 2000)
- Vesela Mukoska-Čingo, *Ustavno sudstvo: teorija i praktika* (Samozal.: Skopje, 2002);
- Aurela Anastasi, *E Drejta Kushtetuese e Krahasuar* (Shtëpia Botuese "Dajti 2000": Tiranë, 2009)
- Petar Bačić, "Ustavna demokracija i sudska uzurpacija ustava." *Zbornik radova Pravnog fakulteta u Splitu*. God. 46 Br. 3 (2009)
- Marko Stanković, *Ustavno sudstvo u savremenim federacijama* (Pravni fakultet Univerziteta u Beogradu: Beograd, 2012) (në gjuhën serbe me alphabet cirilik)
- Milan Podunavac & *Biljana Đorđević* (eds.), *Ustavi u vremenu krize: postjugoslovenska perspektiv* (Univerzitet u Beogradu – Fakultet političkih nauka: Beograd, 2014)
- Mato Arlović, "Međuodnos Ustavnog suda Republike Hrvatske i sudbene vlasti u Republici Hrvatskoj". *Zbornik radova Pravnog fakulteta u Splitu.* God. 52 Br. 2 (2015)
- Olivera Vucic & Dragan M. Stojanovic, "European Model of Constitutional Justice. Its Existence and Perspective". *Zbornik Radova Pravnog Fakulteta u Nisu*. Broj 69 Godina LIV (2015)
- Louis Favoreu,ʃ Patrick Gaïa, Richard Ghevontian,ʃ Jean-Louis Mestre, Otto Pfersmann, André Roux, Guy Scoffoni, *Droit constitutionnel*. 19e édition (Dalloz: Paris 2017)

11. PAS FITIMIT TË PAVARËSISË

Përgjithësisht. - Ky kapitull flet për gjyqësinë kushtetuese si një mekanizëm krejt i ri institucional, i krijuar në **Kosovë** krahas institucioneve dhe organeve të reja kushtetuese. Në aspektin formal, ky organ u themelua me hyrjen në fuqi të ligjit të saj organik në fillim të vitit 2009, Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës **(Ligji nr. 03/L-121)**.[1] Në aspektin real, ndërkaq, formimi i saj ka ndodhur vetëm më datën 26 qershor të vitit 2009, kur gjyqtarët e këtij organi dhanë betimin para Presidentit të Republikës, **Fatmir Sejdiu**, personi që do të gjendet në shkelje të **Kushtetutës së Republikës së Kosovës** vetëm një vit më vonë.[2]

Ligji nr. 03/L-121, sa i përket kompetencës kohore, **ratione temporis**, ka përcaktuar rregulla, të cilat kanë të bëjnë me këtë lloj të juridiksionit. Kushtetuta nuk ka dispozita që flasin për juridiksionin në fjalë të Gjykatës. Kjo do të thotë se, në rastin kosovar, dispozitat kushtetuese nisin të vlejnë kohërisht nga momenti i zbatimit të tyre. Kjo është krejt normale dhe në pajtim me standardin e **Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ),** të cilit i përmbahet me përpikëri Gjykata Kushtetuese. Ky standard përcakton çdoherë një afat të prerë kohor për juridiksionin e saj kundrejt vendeve të reja që kanë ratifikuar (apo kanë aderuar në) në **Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ**). Në rastin e këtyre vendeve, **GJEDNJ** nuk ka pranuar juridiksionin **ratione temporis** për rastet që kanë pasur të bëjnë me kohën para anëtarësimit të këtyre vendeve në Këshillin e Evropës (**KE).** Kjo është kështu jo vetëm në nivel evropian, por edhe sipas rregullave të së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare. Sipas rregullit, në të drejtën ndërkombëtare, detyrimi për një shtet lind kur ai shtet e ka pranuar një gjë të tillë sipas rregullave të së drejtës ndërkombëtare mbi traktatet.[3]

Kjo nënkupton që, normimi konkret i juridiksionit kushtetues **ratione temporis**, për pasojë, në vendet e ndryshme që kanë krijuar gjykata kushtetuese pas rënies së komunizmit ka ngelur në kompetencë eksk-luzive të vendeve anëtare të **KE**-së. Kjo më pastaj, zakonisht është rregulluar me rregullat e brendshme të punës së gjykatës kushtetues respektive. Njëjtë është në rastin me Kosovën, e cila në rregullin 36.3 ("g") ["Kriteret e pranueshmërisë"] të Rregullave të Procedurës (**RP)** përcakton se kërkesa nga neni

---

1 Ky ligj u miratua nga **Kuvendi i Republikës së Kosovës** më 16 dhjetor 2008. Është shpallur me Dekretin Nr. DL-070-2008, të 30 dhjetorit 2008. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* / Prishtinë: Viti IV / nr. 46 / 15 janar 2009. Hyrja në fuqi është rregulluar me nenin 58 ["Hyrja në Fuqi"] të Ligjit, i cili përcakton si kohë të hyrjes në fuqi momentin e publikimit të tij në **Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.**

2 Cf. *Rasti KI 47/10. Aktgjykim. Naim Rrustemi dhe 31 deputet të Kuvendit të Kosovës kundër Shkëlqesisë së tij, Fatmir Sejdiu, President i Republikës së Kosovës.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. Ref.: AGJ 43/10. Prishtinë, më datën 28 shtator 2010, paragrafi II i pjesës operative të Aktgjykimit, **që konstaton shkelje serioze te Kushtetutës së Kosovës, respektivisht të nenit 88.2 të Kushtetutës, nga Shkelqesia e Tij, Fatmir Sejdiu, duke mbajtur njëkohesisht postin e Presidentit te Republikes së Kosovës si dhe postin e Kryetarit të Partisë Politike - Lidhja Demokratike e Kosovës, LDK-së.**

3 Për kriteret e lejueshmërisë pranë **GJEDNJ**, që bazohen në parimin e përgjithshëm të së drejtës ndërkombëtare mbi pranimin me vullnet të detyrimit ndërkombëtar, që shtete anëtare e kanë dhënë me qëllim të vënies në jetë të **KEDNJ** dhe protokolleve të saj, cf. më shumë në European Court of Human Rights, *Practical Guide on Admisibility Criteria* (Council of Europe: Strasbourg, 2014) fq. 46-52; Për komentet doktrinare, cf. Karen Reid, *A Practicioner's Guide to the European Convention on Human Rights* (Sëeet & Macëell Ltd.: London, 2004) fq. 31-32 (autori thekson po ashtu se vetëm vullneti i shtetit përcakton vlefshmërinë kohore të shteteve anëtare, pra siç e ka dhënë atë vullnet shteti respektiv me rastin e ratifikimit përkatësisht pranimit të detyrimeve nga **KEDNJ**); Philip Leach, *Taking a Case to the European Court of Human Rights*. Third Edition (Oxford University Press: Oxford, 2011) fq. 151-153 (autori përveç vullnetit të shtetit për të pranuar detyrimet nga **KEDNJ**, diskuton edhe rastet e situatat kur gjykimet nacionale kanë zgjatur shumë dhe saktëson datën e ndërhyrjes në të drejtat dhe lirite e garantuara dhe situatat tjera para hyrjes në fuqi të **KEDNJ,** të cilat duhet të merren parasysh; po ashtu, kjo nuk pengon shtetet që vet me vullnet të zhdëmtojnë palët e dëmtuara për rastet që kanë lindur para marrjes së detyrimit nga shteti i tillë respektiv).

113.7 do të jetë e papranueshme nëse, **inter alia**, nuk është **ratione temporis** në pajtim me Kushtetutën. Këtë standard, Gjykata e ka vënë në jetë që nga vitet e para të formimit të saj. Kërkesat e para në Gjykatë, ndërkaq, janë regjistruar qysh në fillim të vitit 2009, kur u nxor **Ligji nr. 03/L-121** dhe u bë publik themelimi i saj.

Neni 56 ["Rastet Paraprake"] i **Ligjit nr. 03/L-121** ka përcaktuar kufijtë të rreptë kohorë të juridiksionit të Gjykatës kundrejt momentit për paraqitjen e kërkesave që kanë të bëjnë me juridiksionin e tërësishëm të Gjykatës nga neni 113 ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] i Kushtetutës.[4] Njëjtë përcaktohet, sikundër u pa, edhe me rregullin 36. 3 ("g") të **RP**. Të marra së bashku, këto dispozita të **RP** dhe të **Ligjt nr. 03/L-121** përbëjnë parametrat kryesorë, të cilat Gjykata i ka parasysh në secilin rast kur vendos për të hedhur poshtë si të papranueshme kërkesat e palëve për mungesë të juridiksionit **ratione temporis.** Kjo nënkupton se një kërkesë për një çështje që bjen në juridiksionin material të Gjykatës nga neni 113 si më sipër mund të parashtrohet vetëm brenda afateve kohore që kanë të bëjnë me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së vitit 2008 dhe të **Ligjit nr. 03/L-121.** Mirëpo, nga formulimi i rregullit 36.3 ("g") të **RP** si më sipër, rregull me të cilën specifikohen më tutje dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore që kanë të bëjnë me juridiksionin **ratione temporis**, lehtë mund të konkludohet se efektivisht bëhet fjalë për afatet nga juridiksioni i nenit 113.7 i Kushtetutës. Kjo nënkupton se, bazuar në juridiksionin **ratione temporis**, Gjykata duhet të përcaktojë kohën e saktë kur ka ndodhur shkelja e supozuar e një të drejte apo lirie kushtetuese, e kryer nga autoritetet publike kosovare përmes një akti individual të dhënë në një rast konkret apo ndonjë veprimi apo akti tjetër të këtyre autoriteteve. Nenet në fjalë, mund të thuhet se tanimë i takojnë historisë sepse vështirë të besohet që ekziston një situatë, veprim apo akt juridik, e krijuar, kryer apo nxjerrë para datës 15 qershor 2008 e që do të paraqitet si objekt i kontrollit kushtetues në **GJKRKS**.[5]

Në vendimet e Gjykatës, formulimi i arsyetimit në rastet e hedhjes poshtë të kërkesave si të papranueshme për shkak të mosplotësimit të kriterit **ratione temporis** paraqitet si i ngjashëm: në fillim parashtrohen faktet e rastit, të krijuara gjatë procedurave nëpër gjykatat dhe organet tjera të rregullta, duke konstatuar që situata (fakti) e krijuar apo akti i nxjerrë nga autoritetet publike kosovare i takon kohës para hyrjes në fuqi të Kushtetutës, pra para datës 15 qershor 2008. Në rastet kur çështja është rikthyer në rivendosje sërish para një gjykate kosovare të themeluar apo që funksionon sipas dispozitave të Kushtetutës së vitit 2008, pra një situatë (fakt) që prodhon pasoja të vazhdueshme, atëherë Gjykata udhëzon palët që mund të parashtrojnë sërish një kërkesë të re pas përfundimit të procedurave të tilla të rinisura. Kjo nënkupton se çdo gjë tjetër që ka ndodhur para datës 15 qershor 2008, qoftë sa i përket aktit të nxjerrur apo situatës së krijuar faktike, Gjykata përdor një formulim të njëjtë përmes të cilit thekson heqjen e përgjegjësisë së shtetit të ri të Kosovës për aktet apo situatat faktike të krijuara para hyrjes në fuqi të Kushtetutës.

Vendimet për këto raste zakonisht janë shumë të shkurtra, rreth pesë-gjashtë faqe mesatarisht, dhe i takojnë kryesisht periudhës gjatë dy viteve të para pas themelimit të Gjykatës. Më pastaj, me kalimin e kohës, diku pas vitit 2011, ky lloj juridiksioni nuk ka pasur nevojë të shqyrtohet. Edhe në publik, me sa duket, gjerësisht u kuptua se në pikëpamje kohore, juridiksioni nga neni 113.7 i Kushtetutës ka kufizime që nuk mund të tejkalohen: saktësimi i momentit kohor kur ka ndodhur shkelja e supozuar kushtetuese, që zakonisht ka të bëjë me një akt individual juridik të dhënë nga një autoritet kosovar lidhur me një rast apo me veprim konkret, i referohet kohës para hyrjes në fuqi të Kushtetutës, për-

---

4 Neni 56 ["Rastet Paraprake"] **i Ligjit nr. 03/L-121**. "Afatet e përcaktuara në këtë ligj për fillimin e një procedure për çështjet për të cilat është kompetente Gjykata Kushtetuese dhe të cilat janë ngritur para hyrjes në fuqi të këtij ligji fillojnë të llogariten në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji."

5 Rasti i fundit si duket ka qenë *Rasti KI 54/16. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Ramadan Demirovic. Vleresim i kushtetutshmerise se Aktgjykimit te Kolegjit te Apelit të Gjykatës Supreme të Agjencisë Kosovare të Pronës, GSK-KPA-A-002/14, të 14 tetorit 2015.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. Ref.: RK 1099/17. Prishtine, më 3 korrik 2017. Paragrafet. 35-39 (në këtë rast ka pasur dy procedura: në dy procedurat parashtruesi ka pretenduar se ka pasur shkelje të të drejtave të tij kushtetuese; mirëpo, për procedurën e parë, Gjykata ka gjetur se ka përfunduar në vitin 2006, kurse pohimet nga procedura e dytë janë shpallur si qartazi të pabazuara).

katësisht kohës katër muaj pas hyrjes në fuqi të **Ligjit nr. 03/L-121**. Publiku kosovar, thënë me fjalë tjera, e ka kuptuar përfundimisht, diku pas vitit 2011, se Gjykata ka juridiksion **ratione temporis** për çështjet nga neni 113.7 i Kushtetutës vetëm për vendimet e fundit, të formës së prerë, ndaj të cilave janë shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike nacionale deri me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së vitit 2008, përkatësisht deri më datën 15 qershor 2008.[6] Nga hulumtimi i autorëve, i bërë deri në përfundimin

[6] Për pjesën dërrmuese të rasteve të zgjedhura nga Gjykata, të cilat përmbajnë formulimet si më sipër, cf. **inter alia**, vendimet si vijon: *Rasti KI 18/09. Vendim për Papranueshmëri. Reshat Karanxha kundër Këshillit Gjyqësor të Kosovës*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.: RK 49/10. Prishtine, 15 tetor 2010. Paragrafet. 24-25 (duke iu referuar rastit të parë të Gjykatës lidhur me juridiksionmin *ratione temporis,* rasti *Shefqet Haxhiu kundër Organizatës së Punës "Industria e Akumulatorëve"* të datës 21 qershor 2010, në paragrafin 25 konstaton se veprimet kanë ndodhur para datës 15 qershor 2008; në këtë arst Gjykata ka pasur të bëj me kërkesën që nuk lidhej më një akt juridik konkret dhe individual por me pohimet e parashtruesit për veprimet e palës së paditur si cënuese të së drejtës së tij për punë); *Rasti KI 02/11. Aktvendim për Papranueshëmri. Parashtrues: Esat Kurtaliqi. Vleresim i kushtetutshmerisë së Vendimit të Gjykatës Komunale të Ferizajit C. nr. 409/06, të 7 shkurtit 2008*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.: RK179/11. Prishtinë, më 16 dhjetor 2011. Paragrafet. 23-26 (parashtruesi i ankesës nuk ka shfrytëzuar të gjitha mjetet efektive juridike, duke humbur kështu të drejtën për realizimin e të drejtës së tij kushtetuese, të drejtës për punë, mbi bazën ratio temporis sepse procedurat e tij ajnë zhvilluar para hyrjes në fuqi të Kushtetutës së vitit 2008, kurse ndërhyrja në të drejtën e parashtruesit ka ndodhur ne mars 2008); *Rasti KI 18/10. Aktvendim për Papraneushmëri. Parashtruesit: z. Denie D. Mladen dhe z. Vitkovie-Deniq D. Milorad. Vleresim i kushtetutshmerise te Vendimit te Gjykates Supreme te Kosoves, Cml. Gzz. nr. 36/2007, të 13 dhjetorit 2007*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.: RKt34 /11. Prishtinë, me 17 gusht 2011. Paragrafet: 34-42 (në këtë rast Gjykata thekson se nuk ka juridiksion ratio temporis për aktet dhe ngjarjet që kanë ndodhur para datës 15 qershor 2008; edhe po te supozohej se mund të ketë situatë të vazhdueshme në rastin në fjale, nëse shkelja e Kushtetutes ishte shkaktuar nga nje akt i kryer para hyrjes në fuqi të Kushtetutës dhe pasojat e atij akti origjinal ende ekzistojne, që i japin kompetencë Gjykates ta shqyrtoje ankesën, kërkesa është e papranueshme, konstaton Gjykata; kjo papranueshmëri del si pasojë e faktit që parashtruesit nuk kishin shterrur mjetet juridike të parapara me ligj meqë lënda ishte rikthyer për shqyrtim dhe vendosje në gjykatën e shkallës së parë, si gjykatë e faktit, ku ata sërish mund t'i ngrisin pretendimet e tyre; vetëm pasi të kryhen procedurat në fjalë pranë gjykatës së shkallës së parë, atëherë Gjykata Komunale e Prishtinës, parashtruesit sërish mund t'i drejtoheshin Gjykatës Kushtetues); *Rasti KI 12/12. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtruesi: Reshat Murati. Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërise së Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Mitrovicë, E. nr. 709/2006, të 10 dhjetorit 2007*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.: R.KJ21/12. Prishtinë, më 2 nëntor 2012. Paragrafët. 20-24 (në paragrafin 22, Gjykata arsyeton se shkelja e të drejtave ka nodhur para hyrjes në fuqi të Kushtetutës, prandaj në atë kohë as nuk ka pasur kushtetutë dhe as të drejta të garantuar dhe, për pasojë, kërkesa për vlerësim të kushtetutshmëirsë së akti publik të nxjerrë para datës 15 qershor 2008 hedhet poshtë si e papranueshme; për këtë hedhje poshtë Gjykata ka cituar rastet kundër **Kroacisë** dhe **Lituanisë** të **GjEDNJ** në të cilat konstatohej se aktet juridike dhe situatet që janë nxjerrë apo kanë përfunduar para hyrjes në fuqi të **KEDNJ** për palët e paditura, nuk i obligojnë të njejtat palë dhe nuk mund të jenë objekt shqyrtimi në **Strasburg**).
Për rastet tjera, që kanë formulime të njejta si më sipër, cf. edhe si vijon: *Rasti KI 20/09. Vendim për Papranueshmëri. Petrit Morina kunder Aktgjykimit AP.Nr:495!2003 të Gjykatës Supreme të Kosovës, të dates 7 prill 2004*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Ref. nr.: RK 56/10. Prishtine, 18 tetor 2010. Paragrafi: 14; *Rasti KI 26/09. Vendim për Papraneushmëri. Ekrem Gashi kunder Bankes Qendrore te Republikes se Kosoves*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Ref. nr.. RK 36/10. Prishtinë, më 14 dhjetor 2010. Paragrafet. 21-23; *Rasti KI 48/10. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Naser Rexhepi. Vleresim i kushtetutshmërisë së vendimit te Gjykates Ekonomike te Qarkut VI.C.nr 54/2003, të15 prillit 2003 dhe Vendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës Ac.nr 39/2003, të 19 qershorit 2003; dhe Rev.E nr 11/2oo3,te 18 majit 2004.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. Ref.: RK 154/11. Prishtine, më 1 dhjetor 2011. Paragrafet. 21-23; *Rasti KI 100/10. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtruesi:Eduard Thaqi (gjithashtu i njohur si Sokol Thaçi) Vleresim i kushtetutshmerise se Vendimit te Policise se Kosoves, Nr. 398SHPK-2002, te 22 tetorit 2002.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Nr. ref.: 136/11. Prishtinë, me 8 shtutor 2011. Paragrafet: 27-31; *Rasti KI 101/10. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Ismet Hebibi. Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. I. Nr. 165/2004, të 9 nëntorit 2004*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Nr. ref.: RK 106/11. Prishtinë, më 22 mars 2011. Paragrafet. 18-19; *Rasti KI 34/10. Aktvendim për Papranueshmëri.Parashtruesi: Bislim Kosumi kundër Gjykatës Komunale në Podujevë.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Nr. ref.: RK 86/11. Prishtinë, më 25 shkurt 2011. Pargarafet: 15-18; *Rasti KI 58/11. Aktvendim për Papraneushmëri.Parashtruesi: Syle Shlivova. Vlerësim i kushtetutshmërise të Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 82/2002, të 21 gushtit 2002.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Nr. ref.: RK 147/11. Prishtine, me 1 nëntor 2011. Paragrafet. 18-19; *Rasti KI 69/10. Aktvendim për Papranueshëri. Parashtrues: Vehbi Halili. Vlerësim i kushtetutshmërise së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 5/2004, të 10 shkurtit 2004*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Nr. ref.: RK 139/11. Prishtinë, më 4 tetor 2011. Paragrafet. 17-21; *Rasti KI 28/11. Aktvendim për Papranueshmëri.Parashtrues Ismet Boshnjaku Vleresim i Aktgjykimit te Gjykates Supreme (Rev. Nr. 225/2007), te 25 shtatorit 2007.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. Ref.:RK198/12. Prishtine, më 14 shkurt 2012. Paragrafet. 13-15; *Rasti KI 37/10. Aktvendim për Papranueshmëri.Parashtrues: Nebojsa Stanojevic, Dragan Marinkovic dhe 118 ish të punësuarit "N.SH. Banja e Kllokotit". Vleresim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posacme të Gjykatës Supreme Nr. SCEL-06-0016 të datës 10 tetor 2006 dhe Aktvendimit Nr. SCEL 06-016 të datës 31 janar 2007*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Nr.Ref.RK264/12. Prishtinë, 5 korrik 2012. Paragrafet. 28-30; *Rasti KI 66/11. Aktvendim për Papranueshmëri.Parashtrues: Astrit Shabani. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pn-Kr 56/2006, Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Ap. nr. 52/2004 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. nr. 94/01.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Nr. ref.: RK238/12. Prishtinë, më 21 maj 2012. Paragrafet. 14-15*; Rasti KI 94/11. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtruesi: Lumnije Krasniqi. Vleresim i kushtetutshmerisë së Vendimit të Komisionit të Kërkesave Banesore dhe Pronësore HPCC/D/144/2004/C, të datës 27 gusht 2004*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Nr. ref.: RK18S/11. Prishtine, me 18januar 2012. Paragrafet. 23-24; *Rasti KI 129/10. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtruesi: Agron Xhaferi. Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 15/2003 të 30 qershorit 2004*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Nr.Ref·:RK233/12. Prishtinë, më 14 maj 2012. Paragrafët: 17-18; *Rasti KI 132/11. Aktvendim për Papranueshmëri.Parashtrues: Sabile Sopjani. Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 601/02, të 15 shtatorit 2004*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.: RK 214/12. Prishtinë, më 20 mars 2012. Paragrafet: 17-18; *Rasti KI 152/11. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtruesi: Bekim Murati. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Kosovës (11/279), të 07.11.2007.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Nr.Rcf.:RK2S9/12. Prishtinë, më 26 qershor 2012. Paragrafët. 18-26. *Rasti KI 134/11, KI 135/11, KI 136/11, KI 137/11. Avendim për Papranueshmëri. Parashtruesit: Enver Gashi, Shefqet Bici, Ibush Gela, Mustafe Emini. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së 4 Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Nr. Ref,:RK430/13. Prishtinë, më 27 qershor 2013. Paragrafet: 22-28.

e këtij kapitulli (maj 2017), rezulton se ekziston vetëm një rast që ka qenë i viteve të mëvonshme pas themelimit të Gjykatës dhe që ka pasur të bëjë me juridiksionin **ratione temporis**: **rasti KI 54/16** i datës 3 korrik 2017, të cilin e diskutojmë më vonë sërish kur të flasim për juridiksionin nga neni 113.7 i Kushtetutës.

Kjo, si më sipër, shpjegon pse ka qenë e domosdoshme një zgjidhje e tillë e **RP**-ve, përmes së cilës janë vënë në jetë dispozitat kushtetuese dhe ligjore lidhur me ankesën kushtetuese në aspektin e vlefshmërisë së tyre kohore, **ratione temporis**. Kjo prerje kohore ka pasur për qëllim që të sigurojë supremacinë (epërsisë) kohore të Kushtetutës krahas çdo rendi juridik që ka qenë në fuqi para datës 15 qershor 2008. Një prerje e ngjashme kohore e juridiksionit gjyqësor paraqitet edhe me rastin e pranimit të vendeve të ndryshme në **KE** dhe, për pasojë, anëtarësimit të tyre në **GJEDNJ.** Në rastin e **Kosovës**, megjithatë, motivi për një prerje kohore të juridiksionit të Gjykatës ka qenë më i ndryshëm: marrë parasysh gjendjen e gjyqësorit kosovar, atëherë dhe sot, qytetarët e **Kosovës** kanë pasur pritje jashtëzakonisht të mëdha në kohën e themelimit të saj. Ato pritje kanë qenë aq të mëdha sa njerëzit kanë menduar se ky organ do të jetë një antidotë për të gjitha mangësitë e gjyqësorit të rregullt kosovar dhe do të shërbejë si një shkallë tjetër gjyqësore për çështje të faktit dhe të ligjit, si një shkallë e katërt dhe si një zëvendësues i gjyqësorit të rregullt në çdo aspekt.

Kjo **antidotë** nuk shihej nga qytetarët si diçka e kufizuar në kohë: ai besim konsistonte në shpresën e tyre që çdo **padrejtësi e kryer në çdo kohë nga sistemet e kaluara do të mund të jetë objekti shqyrtimi dhe vendosjeje meritore** nga Gjykata Kushtetuese. Kjo ka qenë sfida e parë dhe kryesore e Gjykatës në vitet e para formative të saj, situatë afërsisht e njëjtë me vendet tjera ish-komuniste në vitet e para të themelimit të këtyre gjykatave pas rënies së komunizmit.[7] Në rastin e **Kosovës**, kjo rrethanë bëhej edhe më dramatike marrë parasysh se gjyqtarët e saj të sapozgjedhur në fund të qershorit 2006, gjetën vetëm një objekt të zbrazët, aty ku sot gjendet Gjykata, **në rrugën Perandori Justinian, nr. 44, në Qytezën Pejton në Prishtinë**, e cila dikur kishte shërbyer për nevojat mjekësore të ish-**Armatës Jugosllave**. Siç e kujton autori i parë i këtyre rreshtave, as letra për shkrim nuk kishin pasur në dispozicion, lëre më mjete të tjera teknike. Kjo ka bërë që vendimet e para të saj të shkruhen dhe përkthehen në tri gjuhët (shqip, serbisht dhe anglisht) nga vetë gjyqtarët e saj. Përkundër tërë kësaj situate, **GJKRKS** mori notat më të larta nga trupat monitoruese dhe njerëz të profesionit që kishin përcjellë punën e saj në vitet e para formative.[8]

Një rrethanë tjetër që ka vështirësuar punën e saj në sytë e publikut, në vitet e para të punës, ka qenë lakmia thuajse e secilit jurist të **Kosovës** për t'u bërë pjesë e saj, meqë fjala ka qenë për një institucion me juridiksion të specializuar, të ri dhe të panjohur për rrethanat kosovare.

---

7 Edin Hodzic, *Examining the Role of Constitutional Courts in Post-Yugoslav Transitions. Conceptual Frameqork and Methological Issues* (Analitika: Sarajevo, 2016) fq. 7.

8 Për këtë gjendje të gjërave në **Gjykatën Kushtetuese** gjatë viteve të para formative, cf. më shumë në hulumtimet e detajuara si vijon: Jean Marc Lacourciere, *Report on the Jurisprudence of the Constitutional Court of Kosovo on Human and Minority Rights* (Kosovo Law Center: Prishtinë, 2011) (ku autori flet fjalë miradije dhe analizon punën e Gjykatës përmes analizës së detajuar të vendimeve të saj kryesore që patën ndikim sistemik); Nicolas Mansfield, *Creating A Constitutional Court: Lessons From Kosovo*. (The East-West Management Institute (EWMI): New York, Spring, 2013) (ku autori, si udhëheqës i njërit ndër donantorët më të mdhenjë dhe më të devotshëm të Gjykatës tregon për vështirësitë e fillimit dhe rolin e madh pozitiv që ka pasur kryetari i parë i saj, autori i parë i këtij libri). Në internet: https://ewmi.org/sites/ewmi.org/files/OrgFiles/EWMIOPSKosovoConstitutional Court.pdf (shikuar në shkurt 2017); Krenar Gashi, "Nations in Transit 2012:Kosovo". *Freedom House* (2012) (kua utori tregon se me rrëzimin e **Behxhet Pacollit** dhe me vendimarrjet tjera, Gjykata Kushtetuese ka treguar se dallon esencialisht nga çdo hallkë tjetër e sistemit të drejtësisë sepse ka vepruar si një institucion i pavarur nga politika dhe me profesionalizëm të thellë). Në internet: https://freedomhouse.org/sites/default/files/NIT2012 Kosovo_final. pdf.

Edhe statusi material dhe tjetër që ofrohet ligjërisht për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, ka qenë faktor lakmues.[9] Kjo lakmi duhet të jetë e njëjtë edhe sot, në veçanti sa i përket statusit material.[10]

Në ndërkohë që anëtarët vendorë duhej të ishin vetëm gjashtë përgjatë kohës së ka zgjatur pavarësia, por edhe pas saj deri në qershor të vitit 2018, mbi pesëdhjetë veta kishin konkurruar për t'u bërë pjesë e saj në konkursin e parë të vitit 2009. Në fakt, për t'u bërë anëtar i saj, krejt me arsye legjitime, kishin konkurruar të gjithë juristët më eminentë që kishte **Kosova** në atë kohë. Kjo rrethanë më pastaj do ta rëndojë dukshëm diskursin publik dhe analitik profesional rreth **vendimeve të mëdha** të Gjykatës në ato vite. Këto vendime ishin të destinuara të ishin **të mëdha** sepse e tillë është vetë Kushtetuta e vitit 2008, interpretimi i së cilës nisi pa asnjë traditë paraprake kosovare në lëmin e gjyqësisë kushtetuese të modelit liberal perëndimor.

Gjykata nisi misionin e saj të krijimit të një tradite të re kushtetuese në lëmin e gjyqësisë kushtetuese, në një ambient të traditës së **sistemit civil kontinental të së drejtës**, ku gjyqtarët janë të trajnuar vetëm për ta zbatuar normën, jo për ta interpretuar atë në mënyrë kreative apo për ta krijuar. Detyra e gjykatave kushtetuese post-komuniste ka qenë që të mbrojnë kushtetutshmërinë e re që po lindte, detyrë kjo që i bënte këto gjykata elemente antistrukturore të sistemit juridik. Kjo nënkuptonte se gjykatat në fjalë ishin paradigmatike në sensin që ato duhet të ndiqnin zhvendosjen normative pas rënies së komunizmit dhe ta mbronin zhvendosjen e tillë nga cenimet e strukturave të vjetra të sistemit që kishin mendësi dogmatike dhe formaliste. Kjo kërkonte një aktivizim gjyqësor të këtyre gjykatave, diçka që nuk mund të arrihej përmes gjykatave dhe kuadrit të vjetër gjyqësor që gjendej në gjyqësorin e rregullt.[11]

Kështu afërsisht kanë qenë dhe përvojat e gjykatave kushtetuese ish-jugosllave dhe e gjyqtarëve, rrugët që kanë ndjekur në fazën e transformimit të shoqërive të tyre në drejtim të konstitucionalizmit modern liberal perëndimor.[12] Pjesë e këtij rëndimi, krahas atyre që

---

9 Kjo ka bërë që kandidatët që konkurronin dhe nuk zgjidheshin për gjyqtar, gjenin rastin e parë të favorshëm për të goditur Gjykatën, në emër të gjoja profesionalizmit: komentimi i vendimeve të Gjykatës, pa iu referuar fare vendimit konkret që duhej të ishte objekt kritike, por duke u marr me argumentimin **ad hominem**, që lidheshin kryesisht me kryetarin e parë të Gjykëtës, autorin e arë të këtij libri, vërtetojnë katërcipërisht konstatimin si më sipër. Cf. për "**kritikat dhe analizat profesionale**" të ish-kandidatëve për gjyqtarë kushtetues në raportimet e medies kosovare të cituara në fusnotat 13 & 14, **infra**, dhe teksti që i shoqëron.

10 Njëjtë paraqitet gjendja edhe në shumë vende të vendeve ish-komuniste, bazuar në një hulumtim të thellë të bërë nga **Max Plank Institute**, i njiohur si **CONREASON**, të cilin autorët e këtij libri e kanë shfrytëzuar gjerësisht si model shkrimi dhe si strukturë në pjesën që ka të bëjë me gjyqësinë kushtetuese kosovare, aspektet praktike të kësaj gjyqësie. Në këtë kontekst, **CONREASON** jep disa konstatime emiprike për vendet e **Evropës** ish-komuniste: një ndër to është se gjyqtarët në shumicën e rasteve kanë ardhur nga jeta akademike, sepse gjyqtarët e vjetër janë konsideruar si jo të besueshëm për publikun; tjetër konstatim është se statusi material dhe social i gjyqtarëve të gjykatës kushtetuese ka paraqitur një ndër forcat lëvizëse pozitive të gjyqësisë kushtetuese në krahasim me degët tjera të pushtetit, duke qenë në të njëjtën kohë edhe faktor tërheqës për akademikët. Cf. Andras Jakab, Arthur Dyevre and Giulo Itzovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* (Cambridge Unioversity Press: Cambridge, 2017) (në këtë libër janë dhënë raportimet e hulumtimeve për secilin vend ish-komunist të Evropës dhe në pjesën që flet për gjyqtarët kushtetues, në mënyrë të qartë konstatohet kjo që u tha më sipër; përveç kësaj, ky hulumtim jep edhe gjendjen në vendet e demokracive tradicionale të Evropës, ku fenomeni i njëjtë si më sipër është shpërfaqur pas **Luftës së Dytë Botërore** dhe më vonë gjatë valës së dytë të ndërtimit të gjykatave kushtetuese në **Spanjë** dhe **Portugali**; një pjesë e hulumtimit ka të bëjë edhe me gjyqësinë kushtetuese në vendet e **Amerikës Latine**, ku nuk paraqitet rasti i njëjtë si me **Evropën** sa i përket origjinës së gjyqtarëve kushtetuese dhe statusit të styre social dhe material).

11 *Zdeněk Kühn and* Jan Kysela, "Nomination of Constitutional Justices in Post-Communist Countries: Trial, Error, Conflict in the Czech Republic. *European Constitutional Law Review* Volume 2 Issue 02 (June 2006) fq. 183-208 në fq. 190.

12 Për një analizë të shkëlqyer të punës së ish-republikave jugosllave, si dhe të gjendjes aktuale në lëmin e gjyqësisë kushtetuese, cf. Edin Hodzic, *Examining the Role of Constitutional Courts in Post-Yugoslav Transitions*, në veçanti fq. 14, ku autori potencon mungësën e traditës në gjyqësinë kushtetuese dhe tarditën legale të sistemit kontinnetal të së drejtës civile si pengesa serioze praktike në fillet e para të punës së gjykatave kushtetuese sipas recepteve të demokracive liberale kushtetuese; Cf. për një argumentim të ngjashëm, cf. edhe tek *Zdeněk Kühn, "The Constitutional Court of the Czech Repoublic". Në* András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning, fq. 199-236 në fq. 199-200 (në kontekstin cek).*

asnjëherë nuk arritën të bëhen anëtarë të Gjykatës,[13] më vonë do të bëhen edhe një pjesë e gjyqtarëve të saj të gjeneratës së parë, të cilët do të gëzonin mandat të shkurtuar për shkak se mandati i parë që përcaktuar me short, pa të drejtë rizgjedhjeje.[14]

Shorti përcaktohet me qëllim të ruajtjes së vazhdimësisë institucionale dhe kuorumit në mënyrë permanente.[15] Kjo premisë ligjore bazohej në logjikën që **Kuvendi i Kosovës** do të ishte koshient dhe i përgjegjshëm për të zgjedhur me kohë çdo gjyqtar të ri që mbushte vendin e ngelur vakant. Kjo mbushje e vendit vakant duhej të ndodhë, sipas ligjit në fuqi, së

---

[13] **Riza Smaka** kishte konkuruar për gjyqtarë me gjeneratën e parë, kurse avokati privat **Dastid Pallasaka** në qershor të vitit 2013 kishte synuar ta marr vendin vakant, të lënë pas skadimit të mandatit të dy gjyqtareve një vit më herët. I pari do të jetë aktiv për të "**analizuar profesionalisht**" secilin vendim të Gjykatës për të cilin publiku shfaqte një interes, mirëpo gjithnjë duke theksuar se gjenerata e parë e gjyqtarëve është dashur të zgjidhet nga Kuvendi, jo nga politika. Ky konstatim është kundërthënës në aspekitn logjik sepse Kuvendi i zgjedh gjyqtarët e Gjykatës dhe vetë ai parqet një organ politik. Ky cilësim si politik i organit përfaqësues dhe ligjvënës nuk është gabim sepse ashtu është përcaktuar me Kushtetutë. Si i tillë cilësohet edhe në vendet tjera të demokracive liberale perëndimore. Për këtë ish-kandidat për gjyqtar të Gjykatës nuk ka pasur rëndësi se për cilin vendim të Gjykatës mediat i kërkonin mendim apo koment: çdoherë ka përmendur faktin se gjyqtarët kushtetues të gjeneratës së parë kanë qenë jo të ligjshëm dhe të politizuar sepse nuk qenë zgjedhur nga Kuvendi por nga politika.
Këtë mendim e ka përsëritur pa ndërprerë përgjatë viteve derisa ka qenë kryetar i parë i Gjykatës **Enver Hasani** (2009-2015). Pas kësaj, ish-kandidati për gjyqtar kushtetues, **Riza Smaka**, më kurrë nuk e ka përsëritur një analizë të tillë "**profesionale"**. Ky ish-kandidat për gjyqtar kushtetues, përveç kësaj brenge, jo rrallë ka shfaqur edhe mendime **ad hominem** për kryetarin e gjeneratës së parë të Gjykatës, autorin e parë të këtij libri. Lidhur me këtë, cf. më shumë në raportimet e medies kosovare për sa vijon. **Tribuna shqiptare**, e premte, 2 mars 2012: "Fusnota, zor të dërgohet në Kushtetuese!" fq. 5 **Koha ditore,** e hënë, 21 maj 2012: "ISKP, Zgjedhja e gjyqtarëve kushtetues e politizuar" fq. 6; **Kosova sot**, e martë, 10 shtator 2013: "Depolitizimi shpëton KQZ-në dhe Kushtetuesen " fq. 2-3; **Kosova sot,** e diel, 15 shtator 2013: "Kushtetuesja, a po i bindet politikës?" fq. 1 & 2-3; **Zëri,** e hënë, 7 prill 2014: "Pushtetarët shkelin Kushtetutën", fq. 4-5; **Tribuna,** e diel, 13 prill 2014: "Tranzicioni antikushtetues", fq. 1 & 4-5; **Kosova sot,** e hënë, 16 qershor 2014: "Zbatim i brishtë i Kushtetutës", fq. 4; **Koha ditore,** e diel, 6 korrik 2014: "Gjyqtarët politikë e zbehin kredibilitetin e Kushtetueses", fq. 8-9; **Tribuna,** 16 korrik 2014: "Fol presidente" fq. 1 & 4-5; **Zëri,** e diel/e hënë, 27-28 korrik 2014: "Baballarët" e Kosovës" fq. 1 & 2-3; **Tribuna,** e mërkurë, 3 shtator 2014: "Presidentja mbi Kushtetutën për ndërkombëtarët" fq. 1 & 3; **Tribuna,** 10 shtator 2014: "Jahjaga, keq me Kushtetutën!" fq. 1 & 3; Zëri, 11 shkurt 2015: "Kushtetuesja kërkon 'nëntëshin' ", fq. 6; **Kosova sot,** 4 mars 2015: "Jahjaga ta dekretojë Lumezin" fq. 1 & 2-3; **Koha ditore**, 8 mars 2015: "Smaka: Gjykata Kushtetuese, në shërbim të politikës ditore" fq. 8-9; **Zëri,** 16 mars 2015. "Fundi i Hasanit në Kushtetuese" fq. 1 & 5; **Kosova sot,** 20 mars 2015: "Partitë nuk ndalen, ja skenari për Kushtetuesen" fq. 1 & 2-3; **Zëri**, 11 prill 2015: "Fundi i "Babës" në Kushtetuese" fq. 1 & 7; **Zëri,** e shtunë, 13 qershor 2015: "Enver Hasani edhe dy javë në Kushtetuese", fq. 1 & 6; **Kosova sot**, 23 qershor 2015: "Koalicioni qeveritar gllabëron Kushtetuesen" fq. 1 & 4; **Kosova sot**, 2 gusht 2015: "Peshqit e mëdhenj nuk janë të paprekshëm!" fq. 1 & 2-3; **Kosova sot,** 26 dhjetor 2017: "Politika, armiku më i madh i drejtësisë", fq. 5.
Ish-kandidati i dytë për gjyqtar kushtetues, Dastid Pallaska, po ashtu ka qenë shumë i zëshëm në "**analizat profesionale**", në veçanti tre muajt e fundit para mbarimit të mandatit në qershor 2015 të kryetarit të parë të Gjykatës. Ky person u ekspozua me "**analiza profesionale**" këta tre muajt e fundit, që koincidonin me zgjedhjen e kryetarit të ri të Gjykatës, por që në fakt bëhej fjalë për sulme **ad hominem** kundër personalitetit të ish-kryetarit të gjeneratës së parë të Gjykatës Kushtetuese, autorit të parë të këtij libri. Lidhur me këtë, Cf. **Bota sot**, 2 prill 2015: "Pallaska: Ministri Kuçi dëshiron ta bëjë kryeprokuror Enver Hasanin", fq. 2; **Kosova sot**, 4 prill 2015: "Denoncohet skenari mafioz i Hajredin Kuçit", fq. 1 & 5.
Pas mbarimit të mandatit të tij në qershor të vitit 2015, shkrimet në medie për Gjykatën dhe "analizat profesionale" të këtyre dy ish-kandidatëve për gjyqtarë kushtetues kanë qenë jashtëzakonisht të rralla në krahasim me vitet 2009-2015 dhe nuk kanë qenë **ad hominem**. Kjo edhe përkundër faktit se pas qershorit 2015, nuk kanë munguar "**vendimet e mëdha**" të Gjykatës (vendimet për **Manastirin e Deçanit**, **Asociacionin Serb**, zgjedhjen e Presidentit të Kosovës, formimin e organeve pas zgjedhjeve të qershorit 2017 etj.). Në fakt, asnjëherë nuk do të mungojnë vendimet e Gjykatës që kanë ndikim sistemik në sistem, sepse për këtë ekzistojnë gjykatat kushtetuese dhe gjyqësia që ato e ushtrojnë.

[14] E kemi fjalën për komentet thellësisht joprofesionale, por edhe kundër **Kodit të Etikës të Gjykatës Kushtetuese**, që ua ndalon një ish-gjyqtarëve kushtetuese komentimin e vendimeve të Gjykatës pa u bërë pesë vjet nga mbarimi i mandatit: Cf. **Zëri**, 16 qershor 2014: "Enver Hasani shkel ligjin" fq. 1 & 2; **Zëri,** e diel, 3 gusht 2014: "Mushkolaj: S'ka kthim në pikën zero", fq. 4 & 5; **Zëri**, e premte, 25 shtator 2015: "Kosova urgjentisht të aplikojë në Këshillin e Evropës", fq. 8-9.
Në shkrimin e fundit rreth aplikimit të Kosovës në Këshillin e Evropës, ish-gjyqtarja kushtetuese, **Gjyljeta Mushkolaj**, hapur flet **ad hominem** kundër ish-kryetarit të parë të Gjykatës, duke e cilësuar si të padenjë për të qenë përfaqësues i **Kosovës** në **Komisionin e Venecias**. Kjo nuk do koment! Si përfaqësues i parë i Kosovës në **Komision të Venecias**, autori i parë i këtij libri, është emëruar më datën 12 shtator 2014 me vendimin nr. 547/14 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

[15] Neni 152.2 ["Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese"] i Kushtetutës:
"[…] 2. Nga gjashtë (6) gjyqtarët, dy (2) do të shërbejnë për një mandat trevjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes, dy (2) do të shërbejnë për një periudhë gjashtëvjeçare, pa mundësi të rizgjedhjes, dhe dy (2) do të shërbejnë për një periudhë nëntëvjeçare, pa mundësi të rizgjedhjes. Mandatet e gjyqtarëve fillestarë do të zgjidhen me short, nga Presidenti i Republikës së Kosovës, menjëherë pas emërimit të tyre."

pakut tre muaj më herët para skadimit të mandatit të gjyqtarit aktual.[16] **Kjo doli të ishte naive sepse për dy vende të ngelura vakante në qershor të vitit 2012**[17], Kuvendi nuk do të jetë në gjendje për t'i plotësuar përgjatë tri vitet në vijim, deri në fillim të vitit 2015, kur u zgjodh vetëm njëri nga dy gjyqtarët e dy vendeve vakante.[18] Ky plotësim i vendeve të ngelura vakante, për më tepër, do të bëhet objekt manipulimi dhe shpërdorimi nga ana e gjyqtarëve ndërkombëtarë, të cilët do të bëjnë të pamundurën për të ngelur në pozitën e tyre si gjyqtarë, duke shantazhuar Gjykatën me dorëheqje me qëllim për të tërhequr pas vetes riemërimin dhe një pagesë të majme, të cilat i fitonin në të njëjtën kohë nga vendet e origjinës dhe nga buxheti i **Kosovës.**[19] Nga bux-

---

16 Neni 7. 1 & 2 ["Emërimi dhe fillimi i mandatit"] i **Ligjit nr. 03/L-121**.
"[...]1. Procedura për emërimin e gjyqtarit të ri, sipas këtij ligji, fillon të paktën tre (3) muaj para përfundimit të mandatit të rregullt të gjyqtarit paraprak.
2. Mandati i gjyqtarit të ri fillon në ditën kur përfundon mandati i gjyqtarit paraprak. […]"
Neni 8.2 ["Përfundimi i mandatit"] i **Ligjit nr. 03/L-121**.
"[...] 2. Gjashtë muaj para përfundimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, sipas pikës 1.1. të paragrafit 1 të këtij neni, Kryetari i Gjykatës njofton Kuvendin e Republikës së Kosovës me qëllim që të filloj procedurën për propozimin e gjyqtarit të ri. […]".

17 Në qershor të vitit 2012 ka mbaruar mandati i dy gjyqtareve kushtetuese, **Gjylijeta Mushkolaj** dhe **Iliriana Islami** (me short, secila ka tërhequr nga një mandat tre vjeçar).

18 Edhe në të kaluarën ka pasur raste kur organi përfaqësues nuk ka bërë zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetuese nga frika se ata mund të kontrollojm në punën dhe produket e organit përfaqësues. Rasti i tillë është, ta zëmë, ai i **Gjykatës Kushtetuese të Cekosllovakisë**, e parashikuar për t'u krijuar në shkurt të vitit 1920 por e themeluar pak muaj para **Gjykatës Kushtetuese të Austrisë**. Cf. *Zdeněk Kühn, "The Constitutional Court of the Czech Repoublic". Në* András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, *fq. 199-236 në fq. 202*; Kjo arsye duhet të ketë qenë si hije në sfond të ngjarjeve që lidhen me vonesën kaq të madhe të **Kuvendit të Kosovës** për të zgjedhur me kohë gjyqtarët kushtetues.

19 Njëri prej tre gjyqtarëve ndërkombëtarë, **Robert Carolan**, kishte dhënë dorëheqje më shkrim në shtator të vitit 2014. Gjykata nuk e pat bërë publik një gjë të tillë për shkak se qartë shihej se nuk ishte dorëheqje e mirëfilltë, por një shtirje nga ana e tij për të shantazhuar donatorët ndërkombëtarë të Kosovës për t'ia rritur rrogën. Në seancën e fundit të shtatorit 2014, vetë ky gjyqtar kishte deklaruar se nuk do të rrinte më në Kosovë nëse nuk i plotësohej kërkesa për një rrogë më të madhe.
Shkuarja e tij përkohësisht e pat lënë Gjykatën pa kuorumin ligjor prej shtatë gjyqtarëve. Kjo sepse gjyqtari **Kadri Kryeziu** ishte përjashtuar nga pjesmarrja në gjykime deri në një kohë të pacaktuar për shkak të përfshirjes së tij në fushatë politike në dobi të **PDK**-së (**Partia Demikratike e Kosovës**) gjatë zgjedhjeve të qershorit 2014, kurse gjyqtari i nëntë nuk ishte zgjedhur që nga qershori i vitit 2012. Ngakjo kohë, Gjykata së bashku me gjyqtarin **Robert Caraolan** kishte ngelur në shtatë gjyqtarë, aq sa është kuorumi për vendimmarrje meritore. Në komunikatën e saj për medie, në shtator të vitit 2014, Gjykata vetëm kishte thënë se gjyqtari ndërkombëtar **Robert Carolan** po largohej nga puna për arsye personale.
Më 9 shtator të vitit 2016, ky gjyqtar ka dhënë dorëheqjen e tij përfundimtare. Këtë radhë, dorëheqja ka qenë pasojë e mosvazhdimit të kontratës së tij nga ana e **EULEX**-it për shkak se ai gjendej nën hetime për korrupsion. Ky fakt tregon motivet e tij financiare si shkak për largim të përkohshëm fiktiv në shtator të vitit 2014 për të shantazhuar Gjykatën, e cila atëbotë pa të nuk mund të kishte **kuorum** për shkak të mungesës së tijë, në mënyrë që t'i rritej rroga nga donatorët ndërkombëtarë të Kosovës. Këtë gjë e ka arritur më datën 1 tetor 2014, kur ka fituar kontratën e re. Cf. për raportimet e medieve kosovare lidhur me dorëheqjen e parë fiktive të gjyqtarit ndërkombëtar, **Robert Carolan**, në. **Kosova sot**, e martë, 16 shtator 2014: "Gjyqtari amerikan braktis Kushtetuesen", fq. 1-2; **Bota sot**, e martë, 16 shtator 2014: "Bllokohet edhe Gjykata Kushtetuese! Reagon Enveri:, fq. 6; **Lajm**, e martë, 16 shtator 2014: "Dorëhiqet gjyqtari amerikan", fq. 7; **Epoka e re**, e martë, 16 shtator 2014: "Kushtetuesja ka mbetur me 6 gjyqtarë efektiv", fq. 3; **Zëri**, e martë, 16 shtator 2014: "Ikë gjyqtari i dëshpëruar amerikan", fq. 1 & 7; **Tribuna**, e martë, 16 shtator 2014: "Gjykatësi i ri zgjidhet shpejt", fq. 3; **Bota sot**, e martë, 16 shtator 2014: "Zëvendësimi i gjyqtarit amerikan do të marrë shumë kohë", fq. 5; **Koha ditore**, e martë, 16 shtator 2014" "Kushtetuesja pa kuorum për së paku një muaj", fq. 1 & 3; **Zëri,** e hënë, 29 shtator 2014. "Nga 1 tetori kthehet gjyqtari Carolan", fq. 2; **Bota sot**, e hënë, 29 shtator 2014: "Gjykata Kushtetuese me kuorum, kthehet amerikani Carolan", fq. 12; **Tribuna**, e hënë, 29 shtator 2014: "Zhbllokohet Kushtetuesja", fq. 4; E tërë kjo, po ashtu vërtetohet edhe nga shënimet personale të autorëve të librit për muajt shtator – tetor 2014, si dhe nga transkripetet e seancës së këtyre dy muajve, të cilat gjenden në Gjykatën Kushtetuese, në arkivën e saj.
Nga shkrimet e medies si më sipër shihet qartë se në fillim mendohej gabimisht se largimi i tij ishte bërë për arsye parimore, për shkak të mospajtimeve të tij profesionale me gjyqtarët tjerë në rastin e njohur si **VLAN.** Ky, në fakt, nuk ishte rasti: që nga fillimi bëhej fjalë për një shantazh për rritje të rrogës, duke u kërcnuar me largim dhe humbje të kuoruimit të Gjykatës dhe, për pasojë, paralizë të punës së saj. Pas miratimit të kërkesave të tij për pagë të majme, ai u kthye më datën 1 tetor 2014 (ani se fizikisht as një përqind të kohës nuk ka ndejtur në Kosovë). Cf. lidhur me këtë raportimet e mediave si vijon: **Bota sot**, e martë, 16 shtator 2014: "Reagon Krasniqi: Gjyqtari Carolan, kredibil", fq. 5; **Epoka e re**, e martë 16 shtator 2014: "Krasniqi: Gjyqtari Carolan, kredibil", fq. 3; **Tribuna, e martë**, 16 shtator 2014: "Ideja e Krasniqit", fq. 5; **Lajm,** e mërkurë, 17 shtator 2014: "Shkak i dorëheqjes, zvogëlimi i pages", fq. 1 & 5; **Zëri**, e mërkurë, 17 shtaor 2014: "Gjyqtari e vë në siklet EULEX-in", fq. 1-2); **Zëri,** e mërkurë, 17 shtator 2014: "Carolan, amerikani i dytë që ikë nga Kosova", fq. 3; **Koha ditore,** e shtunë, 20 shtator 2014: "Jena bo me na kajt' Rahoveci", fq. 10; **Koha ditore,** e mërkurë, 24 shtator 2014: "Gjyqtari Carolan negocion kthimin në Kushtetuese", fq. 1 & 3; **Koha ditore,** 26 shtator 2014: "Carolan rikthehet për ta zgjidhur ngërçin politik", fq. 1 & 3; **Zëri**, e hënë, 29 shtator 2014: "Nga 1 tetori kthehet gjyqtari Carolan", fq. 2; **Bota sot**, e hënë, 29 shtator 2014: "Gjykata Kushtetuese me kuorum, kthehet amerikani Carolan", fq. 12; **Tribuna**, e hënë, 29 shtator 2014: "Zhbllokohet Kushtetuesja", fq. 4.

heti i Kosovës këta gjyqtarë janë paguar deri në shumën që kanë marrë gjyqtarët vendor kurse pjesën tjetër nga misioni evropian i sundimit të ligjit në Kosovë, **EULEX**-i apo nga vendet prej nga kanë ardhur Për këtë do të flasim në kapitujt relevantë të këtij libri, që kanë të bëjnë me gjyqtarët dhe zgjedhjen e tyre.

Një rrethanë tjetër që ka shkaktuar rëndim në punën fillestare të Gjykatës, ka pasur të bëjë me vetë esencën e problemit: juridiksioni i saj ka qenë në tërësi i panjohur për të gjitha ata që kishin aplikuar, përfshirë autorin e parë të këtyre rreshtave. Kjo, më fjalë të tjera, vlente për opinionin publik, në veçanti për komunitetin e juristëve të Kosovës që vijnë nga praktika e gjyqësorit të rregullt. Këta të fundit, jo rrallë, do të bëjnë pyetje publike, si me ironi, si mund të ketë gjykatë kushtetuese që nxjerr aktgjykime, që përbëhet nga gjyqtarë që vijnë nga jeta akademike, jo gjyqtarë të gjyqësorit të rregullt dhe nga organi kosovar i akuzës (sic!).[20]

Nuk ishte vetëm **Kosova** ajo që kishte përjetuar këso pyetje keqkuptuese: e njëjta situatë kishte ndodhur me shumicën e vendeve ish-komuniste të **Evropës**. Jo rrallë, gjykatat kushtetuese të këtyre vendeve evropiane ishin stafuar me gjyqtarë të rinj, të ardhur nga jeta akademike për një arsye fare të thjeshtë: gjyqësori i rregullt ishte kompromentuar shumë duke i shërbyer sistemit të vjetër komunist. Orientimi i vendeve evropiane ish-komuniste për akademike u provua si i qëlluar. Kjo sepse, tek e fundit, dija e gjyqësisë së rregullt shumë pak ndihmon në vendimmarrjen e gjyqtarit të gjykatës kushtetuese nisur nga fakti se gjyqësia kushtetuese dhe e drejta materiale që ajo e vë në jetë, përbëjnë një degë të së drejtës skajshmërish **elitike** që kërkon njohje të hollë të aspekteve të thella të filozofisë të së drejtës në përgjithësi dhe të teorisë dhe praktikës komparative kushtetuese në veçanti. Kur kësaj i shtohet edhe fakti që u zu në gojë më sipër, sipas të cilit gjyqtarët e gjyqësorit të rregullt në vendet e **sistemit civil kontinental** janë të trajnuar për zbatim të normës, jo për interpretim kreativ të saj që kufizohet me krijim të normës, që është cilësi e gjyqësisë kushtetuese, atëherë çdo gjë ngelet e qartë sa i përket arsyeve të përzgjedhjes së **akademikëve** si gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese. Në këtë aspekt, puna e gjyqtarëve ndërkombëtarë dhe interaksioni i ndërsjellë i gjyqtarëve vendor me ta në vitet e para formative të Gjykatës ka qenë vendimtar në cilësinë e vendimmarrjes ndër ato vite.

Origjina e gjyqësisë kushtetuese, siç e kemi parë nga kapituj pararendës, daton dhe është formësuar gjatë luftës së saj kundrejt gjyqësisë së rregullt. Kjo e fundit, çdoherë është identifikuar fuqishëm me **ancien regime**. Në rastin e Kosovës, ky **ancien regime** ka nënkuptuar gjyqtarët kushtetues të **Gjykatës Kushtetuese të KSAK (GJKSAK):** juridiksioni i saj dhe përvoja e ndërtuar në te shumë pak kanë mund të ndihmojnë ata që pretendonin ndonjë të thithin njohje nga ta në këtë lëmi. Gjëja e vetme e përbashkët në mes të gjyqësisë kushtetuese të **GJKSAK** dhe asaj të themeluar në vitin 2009, ka të bëjë me formën: në dy rastet bëhet fjalë për modelin **evropian/kelsenian** të gjyqësisë kushtetuese, asgjë tjetër! Çdo ngjashmëri, apo çdo synim për të tërhequr ndonjë paralele në mes tyre vetëm sa shkakton konfuzion. Kjo më së miri shihet nëse analizohen kërkesat (apliakionet) e qytetarëve të Kosovës të paraqitura përmes avokatëve të vjetër, të edukuar në ish-sistemin komunist jugosllav: në të gjitha rastet, pa asnjë përjashtim, ata kanë theksuar dhe ende theksojnë aspektet e **kontrollit të ligjshmërisë**, krahas kërkesës së tyre për kontroll të kushtetutshmërisë. Kjo bëhet për shkak se në ish-**Jugosllavi** (dhe në **Kosovë**), kërkesa për kontroll të ligjshmërisë ka qenë pjesë përbërëse e kërkesës për vlerësim të kushtetutshmërisë.

Tjetër shenjë e tërheqjes së paraleleve në mënyrë të gabuar është fakti se në kërkesat (aplikacionet) e bëra nga avokatët e edukuar në sistemin ish-**jugosllav** ceken kërkesat për shfuqizim të ligjeve dhe normave tjera të përgjithshme juridike, gjë që edhe kjo përbën një relikt jurispru-

[20] Cf. mendimet e "**ekspertëve vendorë**" në. **Zëri,** e diel, 17 prill 2016: "Vendimet 'kundërthënëse' të Kushtetueses", fq. 6; **Kosova sot,** e martë, 26 dhjetor 2017: "Politika, armiku më i madh i drejtësisë", fq. 5.

dencial nga e kaluara ish-**jugosllave**. Kjo kërkesë e tyre e vazhdueshme përbën iluzionin e tyre se në **Kosovë** ekziston një lloj **sui generis** i **actio popularis** që dikur ka ekzistuar në gjyqësinë kushtetuese të **KSAK**. Sikundër dihet, në juridiksionin aktual të Gjykatës nuk parashikohet e drejta për të shfuqizuar apo anuluar normat juridike në procedurat e nisura sipas **ankesës kushtetuese**.

Ky kapitull fillon me narrativin mbi cilësitë themelore të fizionomisë së **Gjykatës Kushtetuese** dhe specifikat e saj. Bazohet në përvojën e autorëve të librit që nga themelimi i Gjykatës, ka shumë rëndësi për lexuesin që të shoh nga dora e parë përvojën e ndërtimit të një institucioni të ri nga e para. Ka qenë përvojë unike, e papërsëritshme, sepse të gjitha aspektet që përbëjnë fizionominë e **Gjykatës Kushtetuese,** kanë shpërfaqur vetveten në formën e tyre ashtu siç janë. Kjo shpërfaqje është manifestuar në të gjitha aspektet: në aspektin juridiksional, sepse ka qenë institucion tërësisht i ndryshëm nga përvoja e kaluar e Kosovës; në aspektin organizativ, sepse është dashur të ndërtohet struktura e brendshme organizative që nga zero, duke detyruar gjyqtarët e gjeneratës së parë që të kryejnë edhe punët administrative dhe tjera në ndërkohën e krijimit të strukturës së saj; në aspektin financiar dhe ekonomik, sepse ka qenë dhe ngelet i vetmi institucion që buxhetin e skicon dhe planifikon vetë, kurse Kuvendi vetëm duhet ta listojë në gjirin e ligjit për buxhetin për secilin vit. Kjo e fundit është standard që është përqafuar, me rekomandim të **Komisionit të Venecias**, në pjesën dërrmuese të vendeve të Evropës ish-komuniste. Të gjitha këto trajtime lexuesi i gjen në seksionin e parë të këtij kapitulli.

Në seksionin e dytë vazhdojmë me narrativin tjetër shumë të rëndësishëm për gjeneratat që vijnë, përkatësisht me tregimin lidhur juridiksionin e kufizuar të Gjykatës gjatë kohës së pavarësisë së ur. Ky kufizim nuk përfundoi me mbarimin e pavarësisë së ur në viti 2012, sepse, në ndërkohë, Kosova hyri në obligime të reja ndërkombëtare. E kemi fjalën këtu për juridiksionin e krijuar me vullnetin e përfaqësuesit të sovranit të **Kosovës**, **Kuvendit të Kosovës**, juridiksion që bazohet në nenin e ri **162**, përkatësisht amendamentin **24** në Kushtetutën e vitit 2008. Me këtë amendament u themelua ajo që në publik njihet si **Gjykata Speciale**. Këtë dy aspekte të juridiksionit të kufizuar i kemi trajtuar në kapitullin pararendës. Këtu, megjithatë, çështja e juridiksionit të kufizuar merr një dimension tjetër, më të thellë se atje.

Pasi ta kemi kryer këtë, në seksionin e tretë shtjellimet tona vazhdojnë me juridiksionin aktual të Gjykatës. Ky seksion ka disa subseksione, dhjetë sosh, aq sa janë paragrafët e nenit 113 të Kushtetutës së vitit 2008, të cilët flasin për juridiksionin dhe palët e autorizuara. Në këto subseksione, në mënyrë të detajuar, sqarohen llojet e juridiksionit aktual të Gjykatës dhe specifikat e tij.

Në seksionin e katërt jepen komentet dhe pyetjet tona, njëjtë si në kapitujt pararendës. Kapitulli mbyllet me seksionin e pestë, ku janë dhënë leximi që i duhet lexuesit për të parë se cilat janë materialet tjera me rëndësi që nuk kemi arritur t'i përpunojmë dhe t'i vejmë të përpunuara në dispozicion të tyre.

11.1. Cilësitë themelore të fizionomisë së Gjykatës Kushtetuese dhe specifikat e saj

Fizionomia e **Gjykatës Kushtetuese** dhe specifikat e saj themelore përcaktohen nga dy faktorë, të cilët janë të përbashkët për të gjitha gjykatat kushtetuese që modelohen sipas sistemit **evropian/kelesnian**. *I pari* ka të bëjë me atë se ajo nuk paraqet pjesë të sistemit gjyqësor kosovar, por është një pushtet i konstituar (***pouvoir constitué***), i ndarë nga pjesët e tjera të pushtetit.[21] *I*

[21] Në disa kushtetuta, gjyqësia kushtetuese llogaritet si pjesë e gjyqësorit. Cf. më shumë për këtë në: European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Models of constitutional jurisdiction* (Council of Europe Press: Strasbourg, 1994); European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *The role of the constitutional court in the consolidation of the rule of law* (Council of Europe Press: Strasbourg, 1994); dhe Lech Garlicki, "Constitutional Courts versus Supreme Courts". *International Journal of Constitutional Law,* Vol. 5 No. 1 (January 2007).

dyti faktor ka të bëjë me juridiksionin e veçantë dhe të ndarë, të përcaktuar qartë me Kushtetutë, që nuk mund të ushtrohet nga asnjë organ tjetër kushtetues. Para se të shtjellojmë gjerësisht dy faktorët si më sipër, t'i themi disa fjalë mbi origjinën e fizionomisë aktuale të gjyqësisë kushtetuese, si një përmbledhje për lexuesin lidhur me atë se si lindi dhe u zhvillua deri në stadin aktual ky profesion shtetëror kaq i rëndësishëm.

Në origjinë të saj, gjyqësia kushtetuese nis me format rudimentare të gjykimeve të konflikteve për kompetencë, e njohur në disa kushtetuta të vendeve evropiane gjatë shek. XIX, për t'u diferencuar si formë e veçantë e dhënies së drejtësisë në mes të dy luftërave botërore. Si shkak kryesor i lindjes së formave rudimentare të gjyqësisë kushtetuese, ndërkaq, zakonisht jepet nevoja për pasjen e një arbitri të tretë për të gjykuar në rastet e konflikteve për kompetencë, horizontale dhe vertikale, negative dhe pozitive. Kjo nevojë i paraprin lindjes së gjyqësisë kushtetuese evropiane/kelseniane dhe gjendet i sanksionuar në kushtetutat evropiane përgjatë shekullit XIX. Pas vitit 1945, nis kristalizimi përfundimtar i kësaj formë të ndarjes së drejtësisë, për t'u bërë standard i pandarë i demokracive kushtetuese bashkëkohore. Ka qenë tragjedia e **Luftës së Dytë Botërore** ajo që përfundimisht bëri që një pjesë e botës liberale perëndimore të gjejë në gjyqësinë kushtetuese një instrument të fuqishëm për kontrollin e pushtetit dhe vullnetit brutal të shumicës. Nevoja për këtë kontroll vuri në syprinë mekanizmin e **kontrollit abstrakt**, si një mekanizëm shumë të rëndësishëm për ruajtjen e parametrave të demokracisë kushtetuese të vendeve ish-diktatoriale pas vitit 1945 (Austria, Gjermani dhe Italia në fillim, kurse më vonë Turqia, Spanja, Portugalia dhe Greqia). Me rrënimin e komunizmit, një nevojë e tillë edhe më e fuqishme i rishfaq si shkak për përhapjen e gjyqësisë kushtetuese më vendet ish-komuniste. Për më tepër, ndjekja e rrugës euroatlantike nga këto vende të Evropës doli në pah si një shtytës i fortë i përhapjes së saj. Edhe këtu **kontrolli abstrakt** u pa si një instrument mjaft i rëndësishëm për trasimin e rrugës euroatlantike të këtyre vendeve, krahas instalimit të **ankesës kushtetuese** si një mekanizëm mjaft i fuqishëm i kontrollit të pushtetit politik.[22] Këto dy aspekte të gjyqësisë kushtetuese qëndrojnë në themel të dallimit të mësipërm në mes të kontrollit gjyqësor dhe kontrollit kushtetues. I pari ka të bëjë me kontrollin incidental të kushtetutshmërisë si formë dominante dhe i takon sistemit amerikan të gjyqësisë kushtetues, kurse i dyti ka të bëjë me kontrollin e kushtetutshmërisë si punë primare dhe e vetme e gjyqësisë kushtetuese dhe organeve që ushtrojnë atë, duke pasur në ballë **kontrollin abstrakt** dhe **ankesën kushtetuese**.

Tani i kthehemi shtjellimeve të dy faktorëve të mësipërm dominues në përcaktimin e fizionomisë së gjyqësisë kushtetuese kosovare, gjithnjë në kontekstin krahasimor.

Si një ***pouvoir constitué***, gjyqësia kushtetuese paraqitet si një veprimtari shtetërore që kryen punë sipas autorizimit shprehimor kushtetues, me një dallim që bën kontrollin e kushtetutshmërisë së veprimeve dhe lëshimeve të të tjerëve. Për dallim nga organet tjera, mbi të cilat qëndron një autoritet përfundimtar për të treguar, siç thuhet ndër laikët, se çka është mirë e çka është keq sipas Kushtetutës, në rastin e Gjykatës kjo nuk është kështu: ajo nuk ka asnjë autoritet tjetër mbi vete përveç autoritetit të Kushtetutës: "Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësive të saj", thotë paragrafi i dytë i nenit 112 ["Gjykata Kushtetuese"] të kapitullit VIII të Kushtetutës, fjali që nuk është përdorur askund tjetër dhe për asnjë organ tjetër kushtetues.

Si një ***pouvoir constitué,*** që dallon nga të gjitha organet tjera kushtetuese, struktura e saj në Kosovë përcaktohet me dy nene të Kushtetutës, respektivisht nenet 4.6 dhe 112.1. Të shohim si duken këto dy nene në kontekstin komparativ dhe në dritën e jurisprudencës së vetë kësaj gjykate, para se të kalojmë në shtjellimin e faktorit të dytë përcaktues si më sipër.

[22] Cf. më shumë për këtë në Maartje De Visser, *Constitutional Review in Europe: A Comparative Analysis* (HART Publishing: Oxford and Portland, Oregon, 2015) fq. 55-78.

Neni 4 i kapitullit I ["Dispozitat Themelore"] të Kushtetutës flet për formën e qeverisjes dhe ndarjen e pushtetit. Në paragrafin e 6-të të këtij neni, pasi flitet për formën e qeverisjes në Kosovë dhe për mënyrën e ndarjes së pushtetit,[23] konstatohet se Gjykata është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe interpretuesi përfundimtar i Kushtetutës. Këtë interpretim Gjykata e bën nëpërmjet ushtrimit të juridiksionit të saj të paraparë në nenin 113 të Kushtetutës ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"], si dhe të **juridiksionit shtesë** që mund të përcaktohet me ndonjë ligj të veçantë.[24] Për juridiksionin e Gjykatës, përfshirë dhe juridiksionin shtesë, do të flasim në vijim të këtij punimi, në seksionin e tretë. Tani mjafton të ceket se kjo që u tha më sipër, paraqet një formulim klasik të vendit dhe të rëndësisë së një gjykate kushtetuese, ashtu siç është konceptuar nga **Hans Kelsen** (Hans Kelsen : 1881-1973).

Fizionomia nga neni 4 si më sipër, rikonfirmohet më tutje në nenin 112.1["Parimet e Përgjithshme"] të kapitullit VIII, të veçantë, që flet për Gjykatën. Në këtë vend thuhet se "[...] Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën". Ky nen është definues i fizionomisë së saj dhe nuk ka implikacione konkrete për juridiksionin e saj, gjë që nënkupton se në mënyrë autonome nuk mund të shërbejë si bazë juridike për vendosje. Ajo gjendet aty më shumë si një vërejtjet për të gjithë autoritetet tjera publike lidhur me rolin dhe pozitën e saj në sistemin e tërësishëm kushtetues, ashtu që askush të mos të ketë asnjë dyshim lidhur me rolin dhe pozitën e vet kushtetuese kundrejt Gjykatës Kushtetuese.

Siç mund të vërehet nga këto dy nene si më sipër, Kushtetuta nuk bën dallim në mes të interpretimit kushtetues (**constitutional interpretation**) dhe kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë (**judicial review**). Me **interpretim kushtetues** nënkuptohet procesi i ndërtimit apo krijimit të kuptimit dhe i sqarimit të kushtetutës nacionale (nëse ekziston si tekst i shkruar), i teksteve të tjera kushtetuese, i normave dhe parimeve të pashkruara që kanë veçori kushtetuese. Me **kontroll kushtetues** apo **kontroll gjyqësor të kushtetutshmërisë**, ndërkaq, nënkuptohet procesi në të cilin vlerësohet nëse sjellja e një akteri kushtetues është në pajtim me kushtetutën, me tekstet tjera juridike apo me parimet që kanë cilësi kushtetuese.[25] Ky i fundit, siç u pa më sipër, mund të ushtrohet nga një organ i ndarë dhe i veçantë me mandat të posaçëm për një gjë të tillë dhe me juridiksion të numëruar në tekstin kushtetues (gjykatat e ndara kushtetuese), ose edhe

---

[23] Neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]:
"1. Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë;
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ;
3. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë;
4. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar;
5. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat;
6. Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës;
7. Republika e Kosovës ka institucionet e veta për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe të integritetit territorial, rendit dhe qetësisë publike, të cilat funksionojnë nën autoritetin kushtetues të institucioneve demokratike të Republikës së Kosovës".

[24] Juridiksionin shtesë dikur parashihej për Gjykatën me nenin 106.1 ["Rezultatet Zgjedhore"] të **Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të 5 qershorit 2008; Në ndërkohë, me amedamentimet e këtij këtij neni, të kryera me Ligjin 03/L-256 të datës 29 tetor 2010, ka ardhur deri te riformulimi i dispozitës së nenit 106.1 si më sipër, të cilat i njihnin Gjykatës Kushtetuese juridiksin shtesë në këtë fushë. Kështu, tani, ai nen thotë kështu. "[...] Neni** 106.1 KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotime dhe qendrat e numërimit si dhe kur të gjitha ankesat që u përkasin votimit dhe numërimit të vendosura nga PZAP-i dhe çdo apel ndaj vendimeve të PZAP-it lidhur me to të jetë vendosur nga Gjykata Supreme e Kosovës." Cf. Ligji nr. 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-073 për Zgjedhjet e Përkohshme ne Republikën e Kosovës. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* nr. 87, datë 16 nëntor 2010. Një rast tjetër ka të bëj me nenin 64.2.3 të **Ligjit Nr. 03/L-04 për Vetëqeverisjen Lokale, të 20 shkurtit 2008.** *Gazeta Zyrtare e Republiëks së Kosovës* nr. 28, datë 4 qershor 2008.

[25] Maartje de Visser*, Constitutional Review in Europe*, fq. 2.

nga krejt sistemi gjyqësor i vendit në të gjitha nivelet, në kuadër të gjykimit dhe vendosjes për rastet dhe mosmarrëveshjet konkrete të natyrës së përgjithshme (gjykatat e rregullta të të gjitha niveleve ose vetëm gjykata më e lartë në vend). U mor vesh, si raste të ndërmjetme janë vendet që kultivojnë organe shtetërore me juridiksion të përzier (**hibrid**).

Ky dallim nuk është teorik, por ka rëndësi të madhe praktike: në rastin e vendimeve të marra lidhur me interpretimin kushtetues, efektet e tyre specifike, si ps.h. **res judicata**, duhen kuptuar vetëm për aq sa janë në fuqi ato. Kjo për shkak se precedentët e gjykatave kushtetuese në rastet e interpretimeve kushtetuese vlejnë vetëm për aq sa janë në fuqi, si puna e normave juridike të cilat i interpretojnë. Në momentin e ndryshimit të precedentit, pushon efekti **res judicata** i vendimeve të mëhershme. Ky nuk është rasti me kontrollin gjyqësor apo kontrollin kushtetues të kushtetutshmërisë: vendimet në këto raste kanë efekt **res judicata** për jetë dhe mote, ani se mund të vijë deri te ndryshimi i precedentit të mëhershëm. Kjo për shkak se efekti i vendimeve vlen vetëm ndërmjet palëve (**inter partes**), në ndërkohë që te rastet e interpretimit të kushtetutës bëhet fjalë për efekte të përgjithshme (**erga omnes**). Lidhur me precedentët gjyqësorë dhe doktrinën **stare decisis**, efektet e përgjithshme (**erga omne**) si dhe efektet specifike të vendimeve të gjykatave kushtetuese, flasim më shumë në kapitulljt trembëdhjetë dhe pesëmbëdhjetë të këtij libri.

Në vijim, si më sipër, **interpertim kushtetues** paraqet vetëm atë operacion mendor që kryhet si interpretim abstrakt nga neni 113 i Kushtetutës, paragrafët si vijon: 2 (pikat 1 & 2), 3 (pika 4), 4, 5, 8 & 9. Juridiksioni shtesë nga paragrafi i dhjetë i nenit 113 të Kushtetutës nuk ka asnjë mundësi që të jetë juridiksion i kontrollit abstrakt të një norme të përgjithshme juridike sepse një situatë e tillë do të binte ndesh me vetë fizionominë e gjyqësisë kushtetuese të tipit **evropian/kelsenian**, ku juridiksioni i kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së një norme nënkupton, në rend të parë, autorizimin e gjykatës kushtetuese për shfuqizim/anulimin të normës së përgjithshme apo të dispozitave të caktuara të saj (**gjykata si ligjvënës negativ**). Pa këtë nuk ka gjyqësi kushtetuese të tipit **evropian/keslenian**. Kohëve të fundit, brenda këtij modeli, gjykatat kushtetuese kanë marrë (uzurpuar) funksione të theksuara të **ligjvënësit pozitiv.** Kjo nuk ndryshon asgjë në këtë që thamë më sipër: gjërat do të ishin krejt ndryshe sikur gjykatat kushtetuese të tipit **evropian/kelsenian** të mos kishin për detyrë të tyre primare shfuqizimin/anulimin e ligjeve dhe normave tjera të përgjithshme (**gjykata si ligjvënës negativ**), krahas kompetencave të tjera që ato i kanë fituar (marrë) për vete si pasojë e evoluimit të këtij profesioni (p.sh. vlerësimi i kushtetutshmërisë së partive politike, i lëshimeve apo ometimeve kushtetuese, i kontrollit kushtetues të vendimeve individuale në sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut, juridiksioni penal i gjykatave kushtetuese etj.).

Ndër ne, në diskursin laik dhe akademik, për dy këto koncepte përdoret termi **interpretim i kushtetutës**, për të shënuar aktivitetin themelor dhe të vetëm të gjyqësisë kushtetuese. Kjo, u mor vesh, nuk është e saktë! Edhe në jurisprudencën e Gjykatës përdoret terminologjia e njëjtë për dy operacionet mendore si më sipër, interpretimi kushtetues dhe kontrolli gjyqësor, për të shënuar tërë aktivitetin që kryhet në sferën e gjykimit kushtetues. Si bazë për këtë jurisprudencë, e cila nuk bën dallimin në mes të **interpretimit kushtetues** dhe **kontrollit kushtetues** si më sipër, ka shërbyer keqkuptimi dhe keqinterpretimi i domethënies së nenit 112.1 të Kushtetutës, nen që definon fizionominë Gjykatës. Një definim i tillë i këtij funksioni gjendet, pa asnjë përjashtim, në të gjitha kushtetutat e vendeve që modelohen sipas modelit **evropian/kelsenian.** Mirëpo, kjo nuk do të thotë asgjë sa i përket juridiksionit specifik të gjykatës kushtetuese brenda këtij modeli të gjyqësisë kushtetuese: kompetencat e gjykatave kushtetuese brenda modelit juridiksional **evropian/kelsenian** nuk dallojnë shumë nga një vend në tjetrin.

Dispozita e nenit 112.1 të Kushtetutës gjendet në parimet e përgjithshme të kapitullit të posaçëm mbi **Gjykatën Kushtetuese.** Ky definim flet për fizionominë e një gjykate kushtetuese të modelit **evropian/kelsenian**. Asnjëherë nuk mund të kuptohet si dispozitë që definon kompetencat konkrete brenda juridiksionit bazik që ka të bëjë me kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së ligjeve. Po të ishte ashtu, siç besohet gabimisht në praktikë, atëherë do të dilte se Gjykata ka vetëm një kompetencë: kontrollin

abstrakt të përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën, për çka edhe flet dispozita e nenit 112.1. Kjo dispozitë nuk mund të nënshtrohet (subsumohet) përmes operacionit mendor (intelektual) të silogjizmit gjyqësor sepse nuk përbën një *premise major* (premisën e epërme) nën të cilën do të duhet të nënvihej *premisa minor* (premise e ultë). Kjo e fundit përbën një rrethanë jetësore, ta zëmë një akt juridik (abstrakt ose individual) apo një veprim (në disa shtete edhe mosveprimi i nënshtrohet kontrollit kushtetues). Për operacionin mendor të silogjizmit gjyqësor janë të përshtatshme vetëm dispozitat nga neni 113 i Kushtetutës, për arsye të thjeshtë se ato janë tërësia e kompetencave që përbëjnë juridiksionin kushtetues të Gjykatës Kushtetuese kundrejt çdo organi tjetër kushtetues. E thënë me fjalë të tjera, dispozitat nga neni 113 i Kushtetutës shërbejnë për të dalluar **Gjykatën Kushtetuese** nga çdo organ tjetër juridiksional që përcaktohet me Kushtetutë, si dhe për ta mbrojtur atë nga çdo organ tjetër kushtetues që eventualisht mund të synojë uzurpimin e kompetencave të saj.

Synimi për reduktim të nenit 112.1 të Kushtetutës në praktikën e **Gjykatës Kushtetuese** përbën një absurd të llojit të vet, që vjen si pasojë e mosnjohjes së dallimit në mes të juridiksionit dhe kompetencës: *e para* përbën një element definues të natyrës së një organi kushtetues, kurse e dyta tregon me saktësi se cilat janë të drejtat dhe detyrat e organit të tillë kushtetues në kuadër të fizionomisë së vet primare të definuar përmes juridiksonit primar kushtetues. Derisa juridiksioni **evropian/kelsenian** ka të bëjë, mbi të gjitha, me interpretim abstrakt të përputhshmërisë së ligjeve dhe normave tjera të përgjithshme me kushtetutën, dhe pa këtë nuk ka fizionomi **evropiane/kelseniane** të gjyqësisë kushtetuese, kjo, megjithatë, nuk është e tëra. Në juridiksion hyjnë edhe çështje të tjera të natyrës definuese të gjyqësisë kushtetuese **evropiane**/**kelseniane**, jo vetëm ajo e kontrolli abstrakt të ligjeve dhe akteve juridike. Kjo përbën vijën definuese të juridiksionit kushtetues të modelit **evropian/kelsenian**.

Implementimi konkret i juridiksionit përcaktues të fizionomisë marrë në tërësinë e tij ka modalitetet e shumta, aq të shumta sa nganjëherë e largojnë atë nga koncepti **evropian/kelsenian**, duke e bërë të vështirë dallimin e tij me sistemet tjera të gjyqësisë kushtetuese që nuk i takojnë modelit në fjalë. Këtij juridiksioni primar, si më sipër, i janë shtuar një dyzinë kompetencash të tjera të çuditshme që sot i ushtrojnë gjykatat kushtetuese. Ndër to është edhe ajo e mekanizmit të **ankesës kushtetuese**, diçka e panjohur për **Hans Kelsen**, kompetenca për të vlerësuar kushtetutshmërinë e partive politike, referendumet dhe kështu me radhë. Mos të flasim këtu për **kontrollin incidental**, këtij relikti të sistemit amerikan, i cili ka marrë dimensione të panjohura që nuk i shkojnë aq shumë për shtati gjyqësisë **evropiane/kesleniane**. Ajo çfarë me së paku lidhet me gjyqësinë kushtetuese të modelit **evropian/kelsenian** është juridiksioni i uzurpuar, aty-këtu, nga disa gjykata si pasojë e **aktivizmit gjyqësor** dhe ka të bëjë me ushtrimin e **rolit këshilldhënës**, në disa raste, nga ana e gjykatave të tilla kushtetuese.

Ky rol nënkupton që një gjykatë kushtetuese bën interpretimin kushtetues pa pasur për objekt kontrolli kushtetues një akt juridik, një veprim apo mosveprim, por vetëm një normë apo parim kushtetues që shërben, në të njëjtën kohë, si objekt dhe si parametër i kontrollit të tillë kushtetues. **Kjo ka kuptimin e një lloj auto-interpretimi**. Këtë e shtjellojmë në vijim për shkak se në Kosovë, në vitet formative të Gjykatës, ka pas nisur një vendimmarrje që ka poseduar të gjitha cilësitë e juridiksionit këshillëdhënës dhe që fare nuk figuron në tekstin e nenit 113 të Kushtetutës e as në asnjë dispozitë tjetër të saj. Kjo lidhet me interpretimin që Gjykata ia ka bërë nenit 112.1 të Kushtetutës. Të shohim si duken argumentet në jurisprudencën e Gjykatës, shikuar nga aspekti komparativ, argument që kanë të bëjnë me ushtrimin e funksionit këshilldhënës në një situatë kur një gjë e tillë nuk parashikohet me tekstin kushtetues dhe vendi i përket sistemit që modelohet sipas receptit **evropian/keslenian**.

Para se të kalojmë në modalitetet e interpretimit të nenit 112.1 të kushtetutës, të kryera nga Gjykata, për lexuesin shënojmë se nga diskutimi si më sipër, besoj se del qartë për lexuesin dallimi në mes të **juridiksionit** dhe **kompetencës**: e para është kuptim abstrakt që definon fizionominë e institucionit që e posedon atë, kurse kuptimi i dytë nënkupton një sërë të drejtash dhe detyrimesh juridikisonale për t'u ushtruar në një rast konkret dhe që shërbejnë si bazë juridike-kushtetuese për vendosjen në një rast apo mosmarrëveshje konkrete kushtetuese. Vetëm kompetenca dhe dispozitat që e normojnë paraqesin instru-

mente të përshtatshme për operacionin mendor të sillogjizmit gjyqësor, asnjëherë dispozitat që definojnë fizionominë primare të Gjykatës. E thënë me fjalë të tjera, kompetenca ka kuptimin e premisës së sipërme (**premisa major**), që subsumon (nënvë) një gjendje faktike kushtetuese. E para, ndërkaq, ka kuptimin e nocionit definues të fytyrës (fizionomisë) së institucionit që vishet me të dhe nuk mund të shërbejë si premisë e sipërme (**premisa major**) që matet me një rast apo mosmarrëveshje konkrete për shkak se nuk është aty me dedikim për të shërbyer si bazë konkrete juridiko-kushtetuese për vendimmarrje. Pa të parën, e dyta nuk ekziston, në ndërkohë që anasjelltas ky nuk është rasti. Prandaj edhe thuhet se në kuadër të juridiksionit kushtetues hyjnë kompetencat e caktuara konkrete të një organi. E thënë edhe më ndryshe, juridiksioni shërben si rrënjë dhe bazë mbi të cilën qëndrojnë kompetencat konkrete të një organi kushtetues.[26]

Në kontekstin kosovar, mënyra se si interpretohet në praktikë dispozita e nenit 112.1 të Kushtetutës duhet të kuptohet si një **aktivizëm gjyqësor.** Kjo nuk mund të kuptohet ndryshe për shkak se nuk ekziston asnjë dispozitë materiale kushtetuese dhe ligjore që autorizon interpretim të Kushtetutës së vitit 2008 në mungesë të ekzistimit të një ligji apo akti tjetër juridik të natyrës së përgjithshme që shërben si objekti i kontrollit kushtetues. Thënë ndryshe, në **Kosovë** nuk ka asnjë dispozitë kushtetuese apo ligjore që autorizon Gjykatën për të ushtruar funksion këshilldhënës, i cili nënkupton vlerësim të përputhshmërinë me Kushtetutën, sipas kërkesës së një pale të autorizuar që ka status të privilegjuar, të një situate apo akti juridik të përgjithshëm kushtetues që nuk përbën ligj apo akt tjetër juridik të përgjithshëm. Kjo është kështu për shkak se dispozita e nenit 112.1 nuk është dispozitë operative juridiksionale por dispozitë definuese e fizionomisë së gjyqësisë kushtetuese të **Kosovës**[27]. Asgjë tjetër! Këto gjëra i diskutojmë sërish në vijim kur flasim për juridiksionin aktual abstrakt të Gjykatës (nënseksionet që kanë të bëjnë me trajtimin e juridiksionit abstrakt në kuadër të seksionit të tretë të këtij kapitulli), si dhe për **aktivizmin gjyqësor** në Kosovë (kapitulli i 14 në vijim)**.**

Trajtimi i dispozitës së nenit 112.1 si dispozitë operative nuk mund të arsyetohet me faktin se Kushtetuta nuk ka dispozita të qarta që operacionalizojnë dispozitën si më sipër: neni 113.1 që bën fjalë për juridiksionin dhe palët e autorizuara, në mënyrë të qartë flet për kompetencën e Gjykatës për të vendosur, pra jo për të dhënë mendim këshilldhënës.[28] Kjo vendosje, sipas kësaj dispozite, ka të bëjë me çështjet konkrete dhe të prekshme e që kanë të bëjnë me si vijon:

---

[26] Ky dallim në mes të juridiksionit dhe kompetencës, e para si diçka abstrakte kurse e dyta si diçka krejt konkrete, ka lindur në kontekstin e një gjykimi në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë (**GJND**), në rastin e **Kanalit të Korfuzit** (1947-1949). Në këtë rast, gjyqtari **Igor Daxner** ka shprehur rezervat ndaj vendimit të **GJND** për këtë rast, duke theksuar se po ngatërronte këto dy kuptime. Sipas tij, juridiksioni kishte dy kuptime fundamentale. Në rend të parë, ai nënkuptonte njohjen nga të tjerët se një organ ishte i veshur me të drejtën për të vendosur dhe, në këtë cilësi, ofronte mundësinë për të tjerët për t'u paraqitur pranë tij. Në kuptimin e dytë, fjala juridkision përdoret për të përcaktuar (identifikuar) të drejtën e detyrën e një organi që është veshur me autorizimin për të vendosur në një rast konkret. Ky dallim më pastaj është elaboruar gjerësisht nga doktrina dhe praktika juridike edhe në sferat tjera të profesionit të gjykimit, për t'u bërë sot një standard gjerësisht i pranuar për dallim në mes të dy kuptimeve. Cf. Veijo Heiskanen, "Jurisdiction v Competence: Revisiting a Frequently Neglected Distinction." *The Finnish Yearbook of International Law* Volume V (1994 fq. 1-33 në fq. 2-3 (fusnota nr.4).
Në ditët tona, përfundimisht dihet që kuptimi i parë, **juridiksioni**, kryesisht i përshtatet konceptit lejueshmërisë, kurse i dyti, **kompetenca**, i shkon për shtati meritave të rastit. Pa u zgjedhur lejueshmëria, nuk mund të kalohet në trajtim të meritave të rastit, të cilat përfshijnë edhe çështjen nëse gjykata apo organi që ka vendosur, ka qenë kompetent për vendosjen e një rasti apo mosmarrëveshjeje konkrete. Lidhur me këtë, cf. më shumë shtjellimet e shkëlqyeshme në terrenit e së drejtë ndërkombëtare dhe më gjerë, në punimet si vijon: Hans Smit, "The Terms of Jurisdiction and Competence in Comparative Law". ***The American Journal of Comparative Law***, Vol. 10, Issue 1-2 (Winter-Spring 1961), fq. 164–169; Luis García-Corrochano Moyano, "Competence and Jurisdiction in Public International Law: International Courts in the Americas". Në Nerina Boschiero, Tullio Scovazzi, Cesare Pitea & Chiara Ragni (eds.), *International Courts and the Development of International Law Essays in Honour of Tullio Treves* (SPRINGER. The Hague, 2013) fq. 149-164; Veijo Heiskanen, "Menage a trois? Jurisdiction, Admissibility and Competence in Investment Treaty Arbitration." *ICSID Review: Foreign Investment Law Journal* Vol. 29 No. 1 (February 2014), fq. 231-246.

[27] Ndër autorët kosovarë, fakti që Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion këshilldhënës, konsiderohet si një hendikep. Mendojmë se nuk qëndron ky konstatim sepse ai lloj juridiksioni mundëson abuzim dhe arbitraritet, përkatësisht politizim të gjyqësisë kushtetuese. Këto dhe gjërat lidhur me aktivizmin gjyqësor i trajtojmë në vijim këtu dhe në kapitullin përkatës mbi aktivizmin gjyqësor. Për autorët kosovarë si më sipër, cf. Dren Doli & Fisnik Korenica, "Kosovar Constitutional Court's Jurisdiction: Searching for Strengths and Ëeaknesses."*German Law Journal* Vol. 11 No. 08 (2010) fq. 803-836 në fq. 814.

[28] Neni 113.1 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës. "1. Gjykata Kushtetuese **vendos** vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. […]".

- kontrollin abstrakt të normës së përgjithshme juridike;[29]
- kontrollin e vendimeve dhe veprimeve individuale të organeve të pushtetit shtetëror të ndërmarra në vijim të ushtrimit të kompetencave të tyre në kohë paqe dhe në kohë të gjendjes së jashtëzakonshme;[30]
- kontrollin konkret të kushtetutshmërisë së një norme të përgjithshme juridike në kontekst të interpretimit të saj për qëllimet e zbatimit imediat në një rast apo mosmarrëveshje konkrete që gjendet për vendosje pranë një gjykate të rregullt;[31] dhe, në fund,
- kontrollin e kushtetutshmërisë së vendimeve të autoriteteve publike të shqiptuara (dhënat) në sferën e lirive dhe të drejtave kushtetuese të individëve dhe personave juridik që janë nën sovranitetin e Kosovës.[32]

Sikundër shihet, këtu është fjala për nenin që specifikon juridiksionin e Gjykatës duke e zbërthyer të njëjtin në një dyzinë kompetencash krejt konkrete **për të vendosur** lidhur me çështjet e si më sipër. Kjo kompetencë për të vendosur nuk vihet në lëvizje **sua sponte**, me vetiniciativë të Gjykatës, por në një mënyrë ligjore të parashikuar dhe me kërkesë të palëve të autorizuara në mënyrë shprehimore. Kjo vënie në lëvizje e Gjykatës nga palët e autorizuara ka bazë në këtë nen kushtetues apo në ndonjë dispozite tjetër materiale ligjore (Siç thuhet në paragrafin e fundit të dhjetë të nenit 113 të Kushtetutës).Vendosja mbi një rast apo mosmarrëveshje konkrete përfshin kontrollin abstrakt të normave juridike dhe vendimeve individuale të organeve qendrore kushtetuese. Ky nuk është rasti me **kontrollin gjyqësor**, i cili përfshin vetëm kontrollin konkret të kushtetutshmërisë së një akti apo veprimi individual të një autoriteti publik kosovar, pra të një autoriteti që nuk është politik, të ndërmarrë në vijim të ushtrimit të autorizimeve të tyre publike. Vendimi i tillë duhet të jetë përfundimtar dhe i formës së prerë, i marrë në vijim të konkretizimit të një norme të përgjithshme në një situatë të caktuar konkrete jetësore.

Krejt kjo si më sipër duhet të kuptohet si diçka që kërkon në mënyrë imperative plotësimin e disa kushteve të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për të qenë e rregullt dhe e drejtë një procedurë nga neni 113 i Kushtetutës. Kjo do të thotë se duhet të ekzistojë një subjekt i kërkesës dhe një mënyrë ligjërisht e pranueshme për parashtrimin e saj, si e vetmja mënyrë që Gjykata të vendosë lidhur me rastin. Mënyra e parashtrimit të kërkesave në Gjykatë rregullohet, përveç më Kushtetutë, me **Ligjin nr. 03/L-121** dhe **RP të Gjykatës**, kurse çështja e palës së autorizuar normohet vetëm me Kushtetutë. Gjykata nuk mund të zbulojë subjekte të tjera kushtetuese jashtë atyre që kanë autorizime konkrete nga neni 113, për vënien në lëvizje të procedurave të parashikuara me atë nen, përfshirë këtu procedurat e veçanta të përcaktuara me një ligj të veçantë në kuptim të paragrafit të fundit të nenit 113 si më sipër. Askund, në asnjë vend, nuk mund të vërehet se Gjykata ka **juridiksion këshilldhënës** apo për të vendosur për interpretim të Kushtetutës jashtë ekzistimit të një objekti në kuptim të nenit 113. Thënë ndryshe, si palë dhe juridiksion kushtetues mund të kualifikohen vetëm subjektet dhe situatat juridiksionale ashtu siç parashikohet në Kushtetutë, **Ligjin nr. 03/L-121** dhe **RP të Gjykatës**.

Tërë ky diskutim deri këtu na sjell te dallimi i rëndësishëm që ekziston në **literaturën italiane**, në mes të **objektit të interpretimit**, në njërën anë, dhe **parametrave që përdoren për interpretim**, në anën

---

[29] Kontrolli abstrak i normës juridike ka të bëjë si me normat ligjore e statutare, ashtu edhe me ato të natyrës së amendamenteve kushtetuese të përmbajtura në një amendament kushtetues. Lidhur me këto të fundit flasim në seksionet në vijim, kur të diksutojmë doktrinën kosovare mbi **amendamentet kushtetuese dhe kontrollin e kushtetutshmërisë së tyre.**

[30] Këtë e diskutojmë në vijim kur të flasim për juridiksionin dhe palët e autorizuara nga neni 113. 3 (pikat 1 – 5) i Kushtetutës.

[31] Këtë e diksutojmë në vijim kur të flasim për juridiksionin dhe palët e autorizuara nga neni 113. 8 (pikat 1 – 5) i Kushtetutës.

[32] Këtu fjala është për juridiksionin nga neni 113.7 dhe përfshinë si personat fizik ashtu dhe ata juridik. Shtetësia nuk luan rol: kjo dispozitë përfshinë të gjithë ata që janë nën sovranitetin, përkatësisht nën juridiksionin e **Shtetit të Kosovës**. Deri më sot ka pasur vetëm tri vendime ku si palë janë paraqitur të huajt. Në tri raste, Gjykata i ka hedhur poshtë kërkesat e tyre si të papranueshme sepse nuk kanë plotësuar kushtet e pranueshmërisë.Cf. *Rasti KI 72/10. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtruesi: AGEF Gmbh përmes përfaqësuesve të autorizuar. Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Kuvendit Komunal të Prishtinës Nr. 353-1297, të datës 29 qershor 2010.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.: RK101 /11. Prishtinë, më 21 mars 2011; *Rasti KI 121/10. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Sitaram Chaulagai, Krishna Bandur Chamlagai, Chandra Kala Chauhan, dhe Hom Bahadur Battarai Vleresim i kushtetutshmërisë së vendimeve të Gjykatës së Lartë për Kundervajtje ne Prishtinë GJL. nos. 1258/2010, 1259/2010, 1260/2010, 1261/2010, te 22 nëntorit 2010.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.: RK177/11. Prishtinë, më 14 dhjetor 2011; *Rasti KI 147/11. Aktvendim për Papranueshmëri.Parashtrues: Maria Strugari. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, GJL. nr. 1288/2011, të 28 tetorit 2011*. Nr. ref.: RK215/12. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 20 mars 2012.

tjetër. Ky dallim bëhet me shumë të drejtë dhe eviton çdo keqkuptim sa i përket fizionomisë së gjyqësisë kushtetuese **evropiane/kelseniane**, ku sigurimi i supremacisë (epërsisë) së kushtetutës sigurohet përmes mekanizmave të kontrollit abstrakt, në rend të parë, pastaj edhe përmes procedurave të tjera të kontrollit të kushtetutshmërisë së veprimeve dhe lëshimeve të autoriteteve publike. Pa këtë dallim në mes të **objektit** dhe **parametrave** të interpretimit, fizionomia e gjyqësisë kushtetuese kosovare, si pjesë e botës evropiane/kesleniane, nuk do të kishte asnjë kuptim. I pari ka të bëjë me atë që shqyrtohet dhe mbi të cilin vendoset në një procedurë të gjyqësisë kushtetuese konkrete, kurse i dyti i referohet instrumentariumit të tërësishëm që shërben si bazë për shqyrtim dhe vendosje, duke u nisur nga kushtetuta e deri te aktet të ndryshme juridike që kanë relevancë kushtetuese në zgjidhjen e një rasti apo mosmarrëveshje konkrete.

Si **objekt i intepretimit** çdoherë është një akt juridik, një veprim apo mosveprim i një autoriteti publik (shtetëror), kurse si parametër çdoherë është një normë kushtetuese ose normë tjetër që ka fuqi më të lartë se akti juridik, veprimi apo mosveprimi i një autoriteti publik (shtetëror) kushtetutshmëria e të cilëve vlerësohet.[33] Jashtë këtij konteksti, interpretimi kushtetues ka natyrë të **vendimit kështilldhënës** që ndihmon organet tjera për të ushtruar në mënyrë kushtetuese kompetencat e tyre. Në gjyqësinë ndërkombëtare, mendimet këshilldhënëse, që kanë formën e vendimit, përbëjnë një rregull dhe kjo është e natyrshme nisur nga fakti se organet ndërkombëtare funksionojnë në një ambient që dominohet nga sovranitetet nacionale. I tillë është rasti, ta zëmë, me rolin dhe pozitën e **GJND** kundrejt organeve të caktuara të **OKB**-së që kanë autorizim për të kërkuar mendim këshilldhënës në vijim të ushtrimit të funksioneve të tyre të përcaktuara me **Kartën e OKB**. Në të drejtën e brendshme brenda së cilës funksionon gjyqësia kushtetuese **kelseniane/ evropiane**, përfshirë **Kosovën**, ky juridiksion është mjaft i rrallë. Në fakt, juridiksioni këshilldhënës përbën një përjashtim.[34]

Në **Kosovë**, siç u tha, nuk ekziston asnjë dispozitë kushtetuese që përmban edhe më të voglën indicie (shenjë) që çon në përfundimin se lejohet (autorizohet) mundësia për një juridiksion këshilldhënës, që mund të ushtrohet sipas kërkesës dhe për dobi të organeve të tjera shtetërore. E vetmja bazë për një përfundim të tillë, mbase, mund të jetë dispozita e nenit 53 i Kushtetutës, e cila detyron çdo autoritet publik për të vënë në jetë standardet e **GJEDNJ**. Përmes kësaj dispozite kushtetuese, në këtë grup do të hynte edhe autorizimi nga neni 1.1 i **Protokollit nr. 16** në **KEDNJ**, i cili autorizon gjykatat e larta nacionale për të kërkuar mendime këshilldhënse nga **GJEDNJ**. Përmes kësaj analogjie, mbase vetëm teorikisht, Gjykata Kushtetuese do të mund të ndërtonte rastin **pro** ushtrimit të funksionit këshilldhënës.[35] Kjo, megjithatë, do të nënkuptonte që, bazuar në nenit 53 të Kushtetutës, edhe **Gjykata Supreme e Kosovës** do të kishte një mundësi të tillë. Ndoshta këto pikëpamje mund të jenë një mundësi teorike, asgjë më shumë. Kjo është kështu nisur nga fakti i thjeshtë se, po të ndiqej kjo logjikë, atëherë i tërë gjyqësori kosovar, jo vetëm **Gjykata Kushtetuese**, do të viheshin në shërbim të dhënies së këshillave për ekzekutivin dhe legjislativin e vendit me qëllim që të njëjtat organe të ndihmoheshin në kryerjen e detyrave të tyre kushtetuese. Jo vetëm kaq! Përtej këtij spekulimi teorik, vlen të theksohet se vetë ky autorizim i gjykatave nacionale për të kërkuar mendim këshilldhënës nga **GJEDNJ** mund të ushtrohet vetëm në kuadër të zgjidhjes së një rasti apo mosmarrëveshjeje konkrete që gjendet në gjykatën nacionale referuese. Kështu thuhet në paragrafin e dytë dhe të tretë të nenit të parë si më sipër të **Protokollit nr. 16**. Kjo nënkupton se këtu bëhet fjalë për një version pan-evropian të **kontrollit incidental.**[36]

---

33 Lucio Pegoraro, *Giustizia costituzionale comparata. Dai modelli ai sistemi* (G. Giappichelli Editore. Torino, 2015) fq. 158-178.

34 Wojciech Sadurski, *Rights Before Courts. A Study of Constitutional Courts in Postcommunist States of Central and Eastern Europe* (Springer: Dordrecht, The Netherlands, 2008) fq. 13.

35 "Protocol No. 1 to the Convention on the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms". *Council of Europe Treaty Series - No. 214*. Në internet: http://www.echr.coe.int/Documents/ Protocol _ 16ENG.pdf (shikuar në janar 2018).

36 Cf. më shumë për lindjen dhe kontekstin e lindjes së kësaj ideje e praktike krahasuar me vendet tjera jashtë **Evropës**, në Maria Dicosola, Cristina Fasone & Irene Spigno, "The Prospective Role of Constitutional Courts in the Advisory Opinion Mechanism Before the European Court of HumanRights: A First Comparative Assessment with the European Union and the Inter-American System" *German Law Journal* Vol. 16 No. 6 (2015) fq. 1387-1428.

Për dallim nga **modeli difuz (i decentralizuar)** i gjyqësisë kushtetuese,[37] në të cilin duhet patjetër të ketë një rast dhe mosmarrëveshje për të gjykuar mbi kushtetutshmërinë e një norme të përgjithshme juridike, në modelin **evropian/kelsenian** një kusht i tillë nuk ekziston: kontrolli i normës, qoftë **ex ante** (para hyrjes në fuqi por pas miratimit në parlament) apo **ex post** (pas shpalljes dhe hyrjes së ligjit në fuqi), supozohet se është abstrakt dhe nuk i referohet asnjë rasti apo mosmarrëveshjeje konkrete. Kjo përfshinë edhe situatat e **kontrollit incidental,** një relikt ky nga sistemi amerikan, kur një kërkesë për kontroll të kushtetutshmërisë së normës bëhet në kontekstin e një rasti apo mosmarrëveshje që pret zgjidhje pranë gjykatës referuese. Kontrolli i kushtetutshmërisë së normës së referuar, prapëseprapë kryhet përmes silogjizmit gjyqësor që vlen për kontrollin abstrakt.

Pikërisht për këtë arsye, pra për shkak se nuk ekziston një rast apo mosmarrëveshje, modeli **evropian/kelsenian** bart një rrezik permanent për gjykatat kushtetuese, që mund t'i fusë ato në rolin e këshilldhënësit meqë para syve të tyre nuk kanë një ngjarje jetësore konkrete (rast apo mosmarrëveshje). Kjo ngjarje jetësore, përmes operacionit mendor të silogjizmit gjyqësor përbën situatën që subsumohet (nënvihet) nën normën kushtetuese, e cila, në të njëjtën kohë, shërben si parametër vlerësimi i kushtetutshmërisë së një norme të përgjithshme juridike. Kjo nuk është kështu në **sistemin difuz** (**të decentralizuar**), të cilin çdoherë, sipas rregullit, ekziston një rast dhe mosmarrëveshje, kurse vendimi gjyqësor me të cilin vendoset, përfshin edhe çështjen e kushtetutshmërisë së normës, por me efekt vetëm për atë rast dhe mosmarrëveshje konkrete (**inter partes**). Nga kjo rregull, megjithatë, në disa vende ekzistojnë përjashtime substanciale. Kështu, ta zëmë, në **Indi**, **Gjykata Supreme** ka autorizim sipas nenit 143 të Kushtetutës për të dhënë mendime këshilldhënëse kur këtë e kërkon presidenti i vendit.[38] Ngjashëm me këtë ekziston edhe në **Kenia.**[39] His-

---

[37] Në **SHBA**, dhjetë shtete federale lejojnë një mundësi të tillë, në ndërkohë që në nivel nacional gjykatat federale të juridiksionit të përgjithshëm nuk e gëzojnë një të drejtë të tillë. Sipas nenit të tretë, paragrafi dy, të Kushtetutës së **SHBA**-ve (1789), gjykatat federale, përfshirë **Gjykatën Supreme**, vendosin vetëm për rastet dhe mosmarrëveshjet konkrete. Kjo arsyetohet me faktin se këto gjykata duhet të qëndrojnë jashtë politikës, gjë që nuk do të ndodhte sikur të posedonin autorizimin për të dhënë mendime këshilldhënëse me fuqi detyruese në dobi të legjislativit dhe ekzekutivit të shteteve amerikane. Si arsyetim tjetër për mospasje të një roli këshilldhënës të gjykatave federale jepet edhe kërkesa e kahmotshme për ruajtjen e parimit të ndarjes së pushteteve, postulat ky i shenjtë në **SHBA**. Në sistemet me sistem të **centralizuar** (**koncentruar**), ku një gjykatë është e ndarë nga gjyqësori rregullt, duke mos qenë pjesë e tij, por as pjesë e asnjërit prej tri pushteteve të ndara, ky rrezik i cënimit të ndarjes së pushteteve nuk shtrohet me ashpërsinë që shtrohet në **sistemin amerikan**. Cf. Aumann, F. Robert, "The Supreme Court and the Advisory Opinion". *Law Journal*, Vol. 4, No. 1 (1937) fq. 21-55 (ku autori spjegon aspektet teorike dhe praktike të këtij rreziku në sistemin amerikan, duke iu referuar dijetarit francez **Aleksis de Tokvil**, austriakut **Hans Kelsen** si dhe shumë autorëve tjerë amerikan të kohës që kanë avokuar shkëputjen sa më të rrept nga tradita britanike ku gjyqtarët shërbenin si këshilltar të mbretit kur ky uhstroonte funksionin gjyqësor); Për arsyet pse mendimi këshilldhënës aktualisht lejohet në nivel shtetëror, jo në kuadër të Gjykatës Supreme dhe gjykatave tjera federale në **SHBA**, cf. William M. Landes and Richard A. Posner, "The Economics of Anticipatory Adjudication" *The Journal of Legal Studies.* Vol. 23, No. 2 (June, 1994), fq. 683-719 (ku autori jep arsyet e ekonomizimit dhe të racionalizimit të lëndëve si shkak për lejimin e mendimeve këshidhënëse në nivel të shteteve amerikane); Mel A. Topf, "The Jurisprudence of the Advisory Opinion Process in Rhode Island" *Roger Williams University Law Review* Vol. 2 issue 2 (Spring, 1997) fq. 207-256 në fq. 210-214 (ku autori jep historikun e zhvillimit të mendimit këshidhënës dhe synimet gjatë **Konventës së Filadelfisë të vitit 1787 për njohjne e një funksioni të tillë edhe për vetë Gjykatën Supreme me arsyen se një gjë e tillë do të shërbente si barrier kundër fuqisë së madhe të legjislativ it amerikan, si dhe për arsyet që në fund kjo nuk u bë realitet).**

[38] Neni 143.1 ["Autorizimi i Presidentit për të konsultuar Gjykatën Supreme"] i **Kushtetutës së Indisë** e vitit 1949. "143. (1). Nëse në çdo kohë Presidentit i duket se ka lidhur një çështje juridike apo faktike, apo ka gjasë që të lind, dhe për natyra e saj ka rëndësi publike që nevojitet marrja e një mendimi nga Gjykata Suprmee, aim und ta referojë çështjen në atë Gjykatë për konsideratë dhe Gjykata mundet, pas shqyrtimit të çështjes siç e sheh të nevojshme, t'i raportojë Presidentit mendimin e vet lidhur me çështjen". Për tekstin e **Kushtetutës së Indisë** të vitit 1949, me amendamentet e vitit 2007, cf. në internet: http://lawmin.nic.in/coi/coiason29july08.pdf (shikuar në shkurt 2018); Për komentet doktrinare, cf. Dr. J.N. Pandey, *The Constitutional Law of India*. 47th Edition (Central Law Agency: Allahabad, India, 2010) fq. 523-528).

[39] Article 163(6) [...] i Kushtetutës së Kenias të vitit. *"Gjykata Supreme mund të japë një mendim këshilldhënës me kërkesë të qeverisë nacionale, çdo organi shtetëror, apo sipas kërkesës së secilës prej qveerive lokale kur ka të bëjë me një çështje që lidhet me qeverisjen lokalke". Pretekstin e plotë të një vendimi që ka natyrë të mendimit këshilldhënës, por me fuqi detyruese, cf.* **Republic of Kenya. In the Supreme Court of Kenyaat Nairobi** *(Coram: Mutunga, CJ;Rawal, DCJ;Tunoi, Ibrahim, Ojwang, Wanjala & Ndungu, SCJJ).* **Advisory Opinion Reference No. 2 of 2013. Në internet:** *http://kenyalaw.org/caselaw/cases/ vieë/91815/ (shikuar në janar 2018).*

torikisht shikuar, kjo përvojë e këtyre vendeve, me sa duket, ka të bëjë me një **traditë koloniale britanike**: një regjim të tillë, të importuar nga anglezët, e kanë ruajtur shumë nga **ish-kolonitë britanike**, siç është rasti me **Australinë**, **Kanadnë** dhe disa prej shteteve në **SHBA,** të cilat kultivojnë **funksionin këshilldhënës** të gjykatave të tyre shtetërore.[40] Përveç kësaj, siç kemi cekur më heret, në **modelin difuz** (**të decentralizuar**) ekziston përjashtimi nga rregulli e efektit **inter partes** të vendimeve që vendosin një rast apo mosmarrëveshje konkrete. Ky përjashtim krijohet me efektin e doktrinës **stare decisis**, sipas së cilës vendimet e instancave më të larta gjyqësore ushtrojnë **rol nomifolaktik** apo unifikues të standardeve materiale dhe procedurale në gjyqësinë nacionale. Ky rol, në njëfarë mënyre, përbën një lloj të funksionit këshilldhënës të gjyqësorit në çështje kushtetuese: vendimi në një rast ndikon drejtpërsëdrejti në zgjidhjen e rasteve dhe mosmarrëveshjeve në të ardhmen.

Përveç si rezultat i **aktivizimit gjyqësor**, i përmendur më sipër, disa kushtetuta në **Evropë** autorizojnë palët në mënyrë shprehimore për të kërkuar nga gjykata kushtetuese një interpretim kushtetues, të ndarë nga procedurat e sfidimit të kushtetutshmërisë së një akti juridik, veprimi ose mosveprimi. Kjo do të thotë se, në këto raste, jo vetëm që nuk ka një rast dhe mosmarrëveshje që pret të zgjidhet sipas **kontrollit incidental**, por nuk ekziston as një akt juridik, veprim apo mosveprim që duhet t'i nënshtrohet kontrollit kushtetues. Në këtë rast nuk ekziston asnjë objekt i kontrollit kushtetues, me përjashtim të situatave të rasteve të **konfliktit për kompetencë**, të cilat zakonisht bien në kompetencë të gjykatave kushtetuese. Në këto raste ekziston një objekt për kontroll kushtetues, përkatësisht një veprim/mosveprim që ka nxitur një konflikt për kompetencë në mes të organeve (në nivel nacional apo në nivel lokal). Përveç këtij përjashtimi, në këtë kontekst, ekzistojnë edhe disa kategori të rasteve kur një gjykatë kushtetuese jep **mendime këshilldhënëse**, të cilat quhen të tilla vetëm në emër. Këtu, në fakt, objekt kontrolli kushtetues paraqitet një akt juridik, në ndërkohë që vendimi që jepet ka natyrë përfundimtare dhe të detyrueshme për të gjithë. I tillë është rasti, ta zëmë, me nenin 141.2 ["Iniciativa për Ndryshim të Kushtetutës"] të **Kushtetutës së Moldavisë**, i cili përcakton se "amendamenti kushtetues së bashku me mendimin këshilldhënës të Gjykatës, që miratohet me votat e së paku katër gjyqtarëve, i dërgohen Parlamentit për miratim".[41] Në të vërtetë, këtu bëhet fjalë, njëjtë si në rastin e **Kosovës**, për kontroll preventiv të kushtetutshmërisë së amendamenteve të propozuara kushtetuese.

Në vijim si më sipër, ajo që duam të sqarojmë këtu me këtë rast ka të bëjë me lloje të tjera të vendimeve, të cilat nuk bëjnë pjesë në rastet si më sipër. Vendimet në rastet e tilla kanë natyrë të një mendimi këshillëdhënës, i cili mund të jetë i detyrueshëm për palët dhe të gjithë tjerët, por jo patjetër. I natyrës detyruese është, ta zëmë, vendimi i **Gjykatës Kushtetuese**

---

[40] Në fakt, ideja e një gjyqësie me funksione këshilldhënëse ka rrënjët në **Anglinë** e kohës së **Mesjetës**, kur **Mbreti** dhe **Dhoma e Lordëve** kishin të drejtën e kërkimit të këshillës nga gjyqtarët për ushtrimin e funksioneve të tyre të ndarjes së drejtësisë dhe të ligjëvnies. Kjo më vonë ngeli si një praktikë e pandryshueshme edhe në modernitet deri vonë, më 2009, kur u themelua Gjykata Supreme. Kjo shpjegon ekzistimin e funksionit këshidhënës të gjykatave të larta në **Australi** dhe **Kanada**, si dhe në disa **ish-koloni britanike**. Në këtë kategori hyjnë edhe ato shtetet amerikane që sot ruajnë këtë funksion, si **ish-koloni britanike**: në të gjitha këto ish-koloni, guvernatori ka pasur të drejtë të kërkojë këshilla nga gjykata më e lartë lidhur ushtrimin e funksioneve shtetërore kolonizatore. Kjo e drejtë tani është bartur në shefin e shtetit të këtyre vendeve sovrane dhe të pavruara. Për zhvillimin historik në Mesjetë dhe deri në fillim të shekullit XX, cf. Robert F. Aumann, "The Supreme Court and the Advisory Opinion". *Ohio State Law Journal* Vol. 4 No. 1 (1937) fq. 21-55 në fq. fq. 29- 34; Për gjendjen e mendimeve këshidhënëse në dhjetë shtete amerikane, natyrën e tyre juridike dhe dallimin me vendimet e detyrueshme, cf. në The S Charles M. Carberry, "tate Advisory Opinion in Perspective " *Fordham Law Review* Vol. 44 Issue 1 (1975(fq. 81-113; Për **Australi** dhe **Kanada**, cf. Paolo Damiani, "La giustizia costituzionale in Australia"; & Caterina Drigo, "La giustizia costituzionale in Canada". Në Luca Mezzetti (ed.), Sistemi e modelli di giustizia costituzionale (CEDAM: Padova, 2009) fq. 687-712 & fq. 657-686.

[41] Cf. Neni 141.2 i **Kushtetutës së Moldavisë** të vitit 1994. Në internet: https://www.constituteproject.org/ constitution/ Moldova_2006.pdf (shikuar në shkurt 2018).

të Bullgarisë kur merret në ushtrim të funksionit nga neni 149.1 (1) i Kushtetutës[42], kurse i natyrës së kundërt, jo-detyruese, vendimi i **Gjykata Kushtetuese të Rumunisë**[43] kur merret në bazë të nenit 146 ("h") të Kushtetutës. Përveç Bullgarisë, instituti i mendimit këshilldhënës ekziston edhe në **Federatën e Rusisë**, në nenin 125.5 të Kushtetutës së vitit 1993. Ky nen është pjesë e dispozitave të normojnë **Gjykatën Kushtetuese të Federatës së Rusisë,** në kuadër të kapitullit shtatë që flet për pushtetin gjyqësor në këtë vend.[44] Në literaturë, të kësaj natyre konsiderohen edhe vendimet e gjykatave kushtetuese në **Gjermani** dhe **Itali**, që udhëzojnë parlamentet e tyre nacionale për mënyrën dhe kohën e ndryshimit të një ligji që nuk ka marrë notë pozitive në procedurën e kontrollit kushtetues. Kjo është kështu sepse në kushtetutat e këtyre dy vendeve nuk ka ndonjë dispozitë kushtetuese që shprehimisht lejon një mundësi të tillë për dhënien e vendimeve që kanë natyrë këshilldhënëse: kjo qasje ka lindur në këto dy vende si pasojë e **aktivizmit gjyqësor** gjatë dekadave të punës së tyre pas themelimit.[45]

Kosova bën pjesë në kuadër të atyre shteteve, si **Gjermania** e **Italia**, ku dhënia e mendimeve këshilldhënëse, që në përmbajtje janë vendime meritore, aktgjykime, ka lindur si rezultat i aktivizimit gjyqësor në jurisprudencën e Gjykatës. E kemi fjalën për atë lloj të vendimeve me të cilat është interpretuar Kushtetuta dhe që kanë pasur për qëllim që njërit prej organeve kushtetuese në nivel vendi t'u ofrohet ndihmë në lidhje me kushtetutshmërinë e mënyrës së ushtrimit të funksioneve të tyre kushtetuese.[46] Këto vendime nganjëherë kanë pasur të bëjnë me vetë organin kushtetues që ka kërkuar interpretimin kushtetues. Jo doemos ky ka qenë rasti çdoherë: këto vendime nganjëherë nuk kanë pasur fare të bëjnë me ushtrimin e kompetencave (autorizimeve) kushtetuese të organit që ka

---

42 **Kapitulli i tetë ["Gjykata Kushteteuse"], neni** 149 (1) i **Kushtetutës së Bullgarisë** së vitit 1991, që flet për kompetencat, thotë. "Gjykata Kushtetuese. 1 bën interpretimin e detyrueshëm të Kushtetutës; 2. vendos lidhur me kushtetutshmërinë e ligjeve të Asamblesë Nacionale dhe të akteve të Presidentit; [...]". Në internet: http://www.parliament.bg/en/const (shikuar në janar 2018); Për komentet akademike, cf. Wojciech Sadurski, *Rights Before Courts*..., fq. 77; Herman Schwartz, *The Struggle for Constitutional Justice in Post-Communist Europe* (The University of Chicago Press: Chicago, 200) fq. 164-193; Një kompetencë e tillë ekziston edhe në Federatën e Rusisë.

43 Kapitulli V ["Gjykata Kushtetuese"], neni 146 ("h") i **Kushtetutës së Rumanisë** të vitit 1991, që flet për kompetencat, thot. "Gjykata Kushtetuese […]. h. ofron një mendim këshidhënës lidhur me propozimin për suspendim nga pozita të Presidentit të Rumanisë […]." Në internet. https://www. constituteproject.org/ constitution/Romania_2003.pdf?lang=en (shikuar në janar 2018)

44 Neni 125.5 i Kushtetutës: "Gjykata Kushtetuese e Federatës së Rusise, me kërkesën e Presidentit të Federatës së Rusisë, Këshillit të Federatës, Dumës Shetërore, Qeverisë së Fedetratës së Rusisë, si dhe autoriteteve legjislative të entiteteve konstitutive të Federatës së Rusisë, bën interpretimin e Kushtetutës së Federatës së Rusisë". Për trajtimet thellësisht akademike të rrezikut nga mendimet dhe aktiviteti këshillëdhënës i Gjykatës Kushtetuese të Federatës së Rusisë, cf. më shumë në Amy J. Weisman, "Separation of Powers in Post-Communist Government: A Constitutional Case Study of the Russian Federation."*American University International Law Review* Vol. 10 Issue 4 (1995) fq. 1365-1398 në fq. 1391-1392, në veçanti fusnotën 175.

45 Klaus von Beyme, "The German Constitutional Court in an Uneasy Triangle Between Parlaiment, Government and the Federal Lander"; Giancarlo Rolla & Tania Groppi, "Between Politics and the Law: Theë Development of Constitutional Review in Italy". Në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West. Democractic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in A Comparative Perspective* (Kluwer Law International: The Hague, 2010) fq. 101-118 & fq. 143-159.

46 Kur kishte refuzuar kërkesën e disa deputetëve serbë për vendet e rezervuara, të cilët kërkonin që të njëjtat vende të ekzistonin edhe për një mandat pas legjislaturës së dalë nga zgjedhjet e vitit 2014, Gjykata **expresis verbis** kishte theksuar se një autorizim i tillë për të kërkuar interpretim të Kushtetutës nuk u takonte deputetëve të Kuvendit. Ky autorizim, gjithnjë sipas Gjykatës, u takonte vetëm organeve shtetërore në nivel qendror, Qeverisë dhe Presidentit, dhe ka për qëllim që t'i ndihmojë të njejtat në ushtrimin e autorizimeve të tyre kushtetuese, apo në ushtrimin e autorizimeve kushtetuese nga ana e organeve tjera përveç atyre që kërkojnë interpretim kushtetues nga Gjykata. Ky autorizim, në fakt, nuk u takon asnjërit prej organeve sepse në nenin 113 janë qartë të pacaktuara autorizimet dhe palët e autorizuara për të nisur një procedurë pranë Gjykatës. Për këtë diskutojmë ende në kuadër të diskutimeve tona për **aktivizmin gjyqësor** në kapitullin e katrëmbëdhjetë. Cf. për vendimin refuzues të Gjykatës në rastin e deputetëve serbë si më sipër, në: *Rasti KO 18/14. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Vesna Mikie dhe 20 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kërkesë per "[..] interpretim të dispozitave të Kushtetutës së Kosovës lidhur me vendet e rezervuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë"* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Nr.ref.:RKs51/14. Prishtinë, më 11shkurt 2014. Paragrafet. 18-22.

kërkuar interpretimin kushtetues lidhur me çështjen e caktuar kushtetuese.[47] Kur Kushtetuta thotë se këto dy organe, Presidenti[48] dhe Qeveria,[49] kanë të drejtën e ngritjes së çështjeve kushtetuese në Kuvend, kjo duhet kuptuar vetëm si një e drejtë që mund të ushtrohet në bazë të nenit 113.1 dhe asnjëherë ndryshe. Pra, formulimi i tillë, që thotë se këto dy organe kanë autorizimin për të ngritur çështje kushtetuese në Gjykatë, duhet të kuptohet vetëm si çështje kushtetuese brenda juridiksionit nga neni 113 dhe asnjëherë në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tyre kushtetuese që janë përcaktues të fizionomisë së tyre. Pala e autorizuar, në këtë rast këto dy organe, dalin sikur janë definuese të gjyqësisë kushtetuese kosovare dhe e juridiksionit të saj, jo Kushtetuta e vitit 2008, e cila duhet të jetë përcaktuesi kryesor dhe parametri kryesor i fizionomisë së secilit organ kushtetues dhe i kushtetutshmërisë në vend. Se kjo është kështu shihet edhe nga fakti se për një organ tjetër kushtetues, në nenin 135. 4 të Kushtetutës[50], në mënyrëe të qartë është definuar se me çështje kushtetuese nënkuptohet vetëm ajo që përcaktohet me Kushtetutë dhe asnjëherë çështja e definuar sipas parametrave të tekeve dhe bindjes së lirë të një organi, në këtë rast të Presidentit dhe të Qeverisë së Kosovës. Sipas kësaj logjike që deri sot është kultivuar, nuk ka asnjë çështje që nuk mund të ngrihet në Gjykatë nga këto dy organe, përshirë këtu kontrollin represiv të marrëveshjeve ndërkombëtare, kushtetutshmërinë e partive politike, si dhe shumë çështje tjera që nuk janë në menynë e juridiksionit kosovar nga neni 113 i Kushtetutës. Për këtë diskutojmë sërish në kapitullin e katërmbëdhjetë, seksionin që flet për **aktivizimin gjyqësor** në gjyqësinë kushtetuese në **Kosovë**.

Në ushtrimin e juridiksionit të saj nga neni 113.2 & 3 të Kushtetutës, Gjykata ka arritur të zgjerojë juridiksionin e saj material **duke u marrë me interpretim të pastër kushtetues auto-referencial**. Me këtë term nënkuptohet interpretimi kushtetues që kryhet jashtë kontekstit të gjykimit nëse një ligj, normë apo akt tjetër juridik i përmendur në dy paragrafët si më sipër të nenit 113 është në pajtueshmëri me Kushtetutën. Kjo ka ndodhur si pasojë e njohjes disa subjekteve kushtetuese nga Gjykata të cilësisë së palëve të

---

47 Kështu, në **rastin e imuniteteve**, kërkues i mendimit të tillë këshilldhënës për nga natyra, kurse vendim meritor në përmbajtje, sepse ka pasur titullin e aktgjykimit meritor të Gjykatës, ka qenë Qeveria e Kosovës, kurse në **rastin e Asociacionit** ka qenë kërkues Presidentja e Kosovës. Si në rastin e parë, ashtu edhe në rastin e dytë, organet kushtetuese **kërkuese** të mendimit/aktgjykimit kanë qenë organet që fare nuk kanë pasur autorizime lidhur me çështjen kushtetuese. Në rastet tjera, siç ishte **rasti Qeska**, kërkuesi i mendimit, Presidenti i Kosovës, ka pasur të bëjë me çështjen e kushtetuese për të cilën ka kërkuar sqarim në mënyrë të drejtprdrejtë. Këto raste i diskutojmë më vonë në kapitullin kur flasim për **aktivizmin gjyqësor**, real dhe të perceptuar, të Gjykatës që nga themelimi i saj. Deri më sot, ndërkaq, të natyrës së mendimeve këshilldhënëese, por me fuqi të detyrueshme sepse kanë formën e vendimeve meritore, aktgjykimeve, kanë qenë këto vendime si vijon: *Rasti KO 80/10. Aktvendim për Papranueshmëri. Kërkesa e Presidentit të Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së tij, Dr. Fatmir Sejdiu, për sqarim të kompetencave në rastin e kryetarit të Rahovecit, z. Qazim Qeska.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Ref. nr. AGJ *46110.* Prishtinë, më 7 tetor 2010; *Rasti KO 97/10. Aktgjykim. Në çështjen e kërkesës së parashtruar nga Ushtruesi i Detyrës së Presidentit, Dr. Jakup Krasniqi, lidhur me mbajtjen e postit të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit dhe njëkohësisht të postit të Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Demokratike të Kosovës.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Nr. Ref.: AGJ 78/10. Prishtinë, më 22 dhjetor 2010; *Rasti KO 98/11.Aktgjykim. Parashtrues: Qeveria e Republikës së Kosovës. Lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.: AGJ138/11. Prishtine, me 20 shtator 2011; *Rasti K0 103/14. Aktgjykim. Parashtrues: Presidentja e Repuhlikes së Kosovës përkitazi me vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 84 (14) [Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverise] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.: AGJ 671/14. Prishtinë, më 1 korrik 2014; *Rasti 130/15. Aktgjykim. Parashtrues: Presidentja e Republikës së Kosovës. Lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar "Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë; Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore" me* frymën e Kushtetutes, me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Nr. ref.:AGJ877/15. Prishtinë, më 23 dhjetor 2015.

48 Neni 84. 9 ["Kompetencat e Presidentit"] i Kushtetutës: "[…] Presidenti i Republikës […]: (9) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese; […]".

49 Neni 93.10 ["Kompetencat e Qeverisë"] i Kushtetutës: "[…] Qeveria ka këto kompetenca: […](10) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese; […]".

50 Neni 135. 4 ["Raportimi i Avokatit të Popullit"] i Kushtetutës. " […] 4) Avokati i Popullit ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute".

privilegjuara procedurale. Një cilësi e tillë e palës së privilegjuar i pranohet Presidentit dhe Qeverisë: këto dy palë kanë fituar përmes jurisprudencës së Gjykatës të drejtën për të ngritur çështje kushtetuese jashtë kërkesës për kontroll kushtetues nga neni 113.2 & 3 i Kushtetutës. Në rastet kur këto dy palë procedurale paraqiten në procedurë pranë Gjykatës jashtë autorizimeve nga dy paragrafët si më sipër, atëherë nuk ka objekt të kontrollit kushtetues. Ai objekt në këtë rast mungon sepse nuk ka një ligj, normë apo akt tjetër juridik në kuptim të paragrafëve 2 & 3 të nenit 113 të Kushtetutës. Në vend të objektit real të përshkruar kësisoj të kontrollit kushtetues, i cili këtu mungon, Gjykata si pikë referimi ka marrë dhe merr nevojën e këtyre palëve të privilegjuara për të adresuar pyetje kushtetuese me qëllim të marrjes së sqarimeve lidhur me natyrën juridiko-kushtetuese të kompetencave të tyre kushtetuese nga nenet 84 dhe 93 të Kushtetutës.[51] Në këto raste, Gjykata ka shkrirë objektin e kontrollit kushtetues në parametrat e kontrollit kushtetues, duke i njëjtësuar. Prandaj e kemi cilësuar këtë operacion mendor (intelektual) të Gjykatës si **interpretim të pastër kushtetues auto-referencial.**

Kosova nuk është e vetme në këtë drejtim, pra në drejtim të ushtrimit të kompetencave që nuk janë të parashikuara **expresis verbis** në tekstin kushtetues apo ligjor: në gjyqësinë kushtetuese komparative, në katër anët e botës, ekzistojnë precedentët kur gjykatat kanë zgjeruar juridiksionin e tyre në të gjitha sferat. Ky zgjerim ka përfshirë juridiksionin material dhe atë procedural, si dhe marrjen përsipër nga gjykatat kushtetuese të rolit të ligjvënësit pozitiv dhe të **pushtetit kushtetutbërës** (**constituent power**) që i përket sovranit. Kjo, në esencë, përbën uzurpim dhe abuzim të pushtetit të gjykatave kushtetuese, gjë që në disa raste ka pasur për pasojë prishjen e vijës ndarëse dhe balansuese në mes të tri pushteteve. Prishja e vijës ndarëse dhe balancuese ndodhë sepse gjykatat kushtetuese shndërrohen në ligjvënës pozitiv dhe në pushtetet kushtetutëbërës, cilësi këto që nuk i shkojnë fizionomisë së gjyqësisë kushtetuese të modelit klasik **evropian/keslenian.**[52] Në literaturë, në përgjithësi kushtetutat kuptohet si dokumente të gjalla, kurse gjykatat kushtetuese që bëjnë uzurpime të llojeve si më sipër të pushtetit merren si mekanizma që supozohet që i japin shpirt dokumenteve të tilla të gjalla. Ky arsyetohet me besimin në progres njerëzor dhe në evoluim, përfshirë këtu aktivitetin shtetëror të gjyqësisë kushtetuese. Për këtë arsye, thuhet në literaturë, ne duhet të mos ndihemi skllevër të **Hans Kelsen**-it, por ekskluzivisht mirënjohës e me synim të hapur për t'i çuar përpara idetë e tij sublime mbi gjyqësinë kushtetuese.[53]

Cilësia e dytë që përcakton fizionominë e Gjykatës, ka të bëjë me **juridiksionin** e saj nga neni 113 i Kushtetutës. Ky juridiksion përcaktohet qartë me Kushtetutë dhe nuk duhet të caktohet ndryshe nga askush, përfshirë këtu Gjykatën. Edhe atëherë kur thuhet se juridiksioni shtesë përcaktohet me ligj, siç bëhet në paragrafin e fundit të nenit 113 të Kushtetutës, fjala është për një juridiksion që nuk mund të jetë veçse në përputhshmëri me dispozitat kushtetuese që rregullojnë fushën respektive që normohet me ligj si juridiksioni shtesë në kuptimin si më sipër (zgjedhjet e përgjithshme dhe vetëqeverisja lokale). Kjo cilësi e fizionomisë së Gjykatës ndyshe njihet si **gjyqësi kushtetuese juridiksionale**, do të thotë se kushtetuta nacionale në mënyrë të qartë dhe pa asnjë dyshim përcakton sferën e të drejtave dhe detyrave të organit që ka monopol për interpretim kushtetues dhe për ushtrim të kontrollit të kushtetutshmërisë. Kjo nënkupton se, parimisht, interpretimi dhe kontrolli kushtetues nuk mund të burojnë nga jurisprudenca, siç ka ndodhur me vendet e të **drejtës së përgjithshme** (**common law**), por duhet qartë të jetë i

---

[51] Rasti i parë në këtë drejtim ka qenë vendimi i njohur si rasti **Qeskaj**, ku Gjykata ka sqaruar natyrën juridike të dorëheqjes, jashtë juridiksionit të numëruar në nenin 113 i Kushtetutës, duke sqaruar nëse një dorëheqje e dhënë në publik nga një bartës i një funksioni publik është e detyrueshme, kurse rasti i fundit ka të bëjë me kërkesën e ngritur nga ish-Presidentja e Kosovës, znj. Atifete Jahjaga, lidhur me interpretimin e natyrës juridike të marrëveshjes për krijimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe dhe pasojave të vënies së saj në jetë për sistemin kushtetues kosovar. Edhe kjo kërkesë nuk ka fare të bëjë me asnjërin prej paragrafëve të nenit 113 të Kushtetutës: thjeshtë është një kërkesë për të marrë këshillë nga Gjykata lidhur me natyrën juridike të një marrëveshje të lidhur në **Bruksel** në mes të **Kosovës** dhe **Serbisë** në vitin 2015 dhe pasojave që ajo mund të prodhojë në rendin kushtetues kosovar nëse vihet në jetë; Për të gjitha rastet konkrete, cf. fusnotën 47, supra, në këtë seksion, dhe tekstin që e shoqëron.

[52] Cf. një studim të shkëlqyer dhe tejet përmbledhës të kësaj tematike në Allan R. Brewer – Carias (ed.), *Positive Courts as Positive Legislators. A Comparative Law Study* (Cambridge University Press: Cambridge, 2011).

[53] Ibid. fq. 31.

shkruar në mënyrë shprehimore në tekstin kushtetues se cili është juridiksioni kushtetues si dhe organi i autorizuar shtetëror për të kryer interpretimin e kushtetutës dhe kontrollin e kushtetutshmërisë. Kjo cilësi e dallon sistemin **evropian/ kelsenian** nga sistemet tjera të gjyqësisë kushtetuese. Kjo nënkupton që si **parametër për interpretim shërbejnë**, në rend të parë dhe mbi të gjitha, dispozitat kushtetuese. Në mënyrë të tërthortë, si parametër interpretues shërbejnë edhe ligjet dhe aket e tjera juridike për aq sa ato konfirmojnë përcaktimet e dhëna në kushtetutë. Përveç ligjeve, kushtetutshmëria e të cilave prezumohet, edhe aktet të tjera juridike që normojnë segmente të caktuare të natyrës kushtetuese mund të shërbejnë si parametër për interpretim. Ndër ne, një natyrë të tillë e kanë, ta zënë, rregullat e brendshme për punën e **Kuvendit të Kosovës**, sepse si të tilla janë të ranguara me Kushtetutë në nivelin e normave kushtetuese. Në vendet tjera, si parametër për interpretim jashtë tekstit kushtetues shërbejnë lloj-lloj tekstesh juridike, që nganjëherë i takojnë historisë së largët nacionale. I tillë, ta zëmë, është rasti me Francën dhe të a.q. tekstet që përbëjnë **bloc de constituionalite** (**blloku i kushtetutshmërisë**), që nis me Deklaratën e vitit 1789 për të drejtat e njeriut dhe të qytetarit dhe përfundon me **Preambulën** e Kushtetutës së vitit 1946. Çështjeve që kanë të bëjnë me **paramterat e interpretimit** i kthehemi sërish në kapitujt tjerë të librit, në veçanti në kapitujt 14, 15 dhe 16 të librit.

Juridiksioni i shkruar në kushtetutë ka përcaktuar dhe përcakton vëllimin dhe llojin e punës së një gjykate kushtetuese. Brenda këtij juridiksioni ekziston një autorizim që përbën cilësinë definuese të gjyqësisë kushtetuese **evropiane/kesleniane**. Ky autorizim ka lindur shumë vonë dhe është në kundërshtim me idenë fillestare të proklamuar nga **Hans Kelsen**. E kemi fjalën për **ankesën kushtetuese**, e cila ka përcaktuar jo vetëm fizionominë e gjyqësisë së re kushtetuese, por edhe vëllimin dhe llojin e ngarkesës së gjykatave kushtetuese. Në vendet ku nuk ka **ankesë kushtetuese** apo ku ekziston **ankesa kushtetuese e tipit jo të plotë**, ngarkesa e gjykatës kushtetuese është shumë e vogël, nga disa raste në vit. Dhe, anasjelltas, në vendet ku mekanizëm **të ankesës së plotë kushtetuese**, ngarkesa e gjykatës është enorme dhe arrin shifrat e qindra dhe mijëra kërkesave që mezi përballohen. Për këtë arsye, në disa gjykata janë vënë në jetë mekanizmat e filtrimit paraprak administrativ të atyre kërkesave të cilat **prima facie** shihet se nuk i përngjajnë një ankese kushtetuese. Në këto vende, ky filtrim bëhet përmes organeve administrative të gjykatës, pra jo përmes ushtrimit të funksionit të saj gjyqësor. Kjo procedurë administrative i ngjason, në një farë mënyre, procedurave të certifikimit në **Gjykatën Supreme të SHBA** (i a.q. **cetriorari**), me një dallim që në rastin e parë kjo bëhet nga persona të stafit administrativ, jo nga gjyqtarët, siç ndodh në **SHBA.**

Që nga themelimi në shkurt të vitit 2009 e deri në shkrimin e këtij kapitulli (maj 2017), Gjykata ka pranuar 1304 kërkesa (aplikacione), nga të cilat 1216 kanë marrë përgjigjen e duhur. Në mesin e këtyre rasteve, vetëm 156 kërkesa (aplikacione) kanë rezultuar të pranueshme, gjë që është në vijë me jurisprudencën e gjykatave tjera kushtetuese në **Evropë që njohin ankesën e plotë kushtetuese.**[54] Kjo nënkupton se shumica e kërkesave (aplikacioneve) janë paraqitur nga individët dhe personat tjerë juridike sipas nenit 113.7 të Kushtetutës. Në 1084 raste, gjykatat e rregullta paraqiten si shkelës të supozuar të lirive dhe të drejtave të qytetarëve, kurse 220 kërkesat (aplikacionet) e mbetura pohojnë shkeljet e të drejtave dhe lirive kushtetuese nga ana e institucioneve dhe organeve tjera të **Kosovës**. Vetëm pak raste, më pak se pesë (5) për qind (%), kanë të bëjnë me kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese dhe të ligjeve.

Në rastin e **Kosovës**, **ankesa kushtetuese** ka një dimension më të veçantë në krahasim me vendet tjera sepse përbën një detyrim të pastër kushtetues sipas të cilit çdo kërkesë e përmbajtur në një ankesë kushtetuese duhet të interpretohet sipas standardeve më të larta të **GJEDNJ.**[55] Kjo gjykatë, sikundër dihet, Përveç rolit të monitorimit të zbatimit të **KEDNJ** nga ana e shtetve anëtare, ka

[54] Maartje de Visser, *Constitutional Review in Europe,* fq. 61-75, 142-155; Elena Malfati-Saulle Panizza-Roberto Romboli, *Giustizia Costituzionale.* Quarta edizione (G. Giappichelli Editore, Torino, 2013), fq. 19-23.

[55] Neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] i Kushtetutës: "Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut."

edhe një funksion të theksuar të një gjykate kushtetuese pan-evropiane sa i përket vënies në jetë të standardeve të Konventës. Vetë kjo e fundit, ndërkaq, ka një status special që kufizohet me një detyrim kushtetues nacional.[56] Kjo ka bërë që në **Kosovë**, **ankesa kushtetuese** të merr pjesë në përqindje të madhe në vëllimin punëve të Gjykatës. Kjo përqindje kaq e madhe bën që, në procedurat e ankimit kushtetues nga neni 113.7 i Kushtetutës, të cilat kanë për objekt kontrollin kushtetues të vendimeve individuale të organeve, të vij deri te testimi, konfirmimi dhe kundërshtimi i secilit aspekt të sistemit juridik-kushtetues në **Kosovë.**[57] **Në të njëjtën kohë, ky mjet juridik paraqet njërin ndër elementet më të dukshme të identitetit të ri kushtetues të Kosovës, në mënyrë të ngjashme siç ka ndodhur me demokracitë kushtetuese që kanë kultivuar ankesën e plotë kushtetuese (si p.sh. Gjermania, Çekia**, **Spanja** etj.) apo **gjysmë të plotë** kushtetuese (**Kosova, Shqipëria, Maqedonia** etj.). Këtu ka nevojë për një sqarim, me qëllim saktësimi për lexuesin, lidhur me Kosovën dhe ankesën e saj kushtetuese, për ta dalluar atë nga rasti gjerman dhe çek.

Në Kosovë, Gjykata nuk mund të anulojë ligjin, përkatësisht ta shpallë jo kushtetues, në procedurat sipas aneksës kushtetuese. Në rastin gjerman, cek, spanjoll etj., që kultivojnë **ankesë të plotë kushtetuese**, në procedurat sipas saj mund të vij deri te anulimi, përkatësisht deri te shpallja jo kushtetuese e ligjit që ka shërbyer si bazë për vendimin individual që sfidohet me ankesë. Vlen të thuhet, po ashtu, se edhe në **Kosovë** vendimi individual mund të shpallet jo kushtetues, përkatësisht të anulohet për shkak se shkelja kushtetuese bazohet në një normë juridike që ka prodhuar jo kushtetutshmërinë e aktit, por vetë norma juridike ngelet në fuqi. Ajo mund të anulohet, përkatësisht të shpallet jo kushtetuese me efekt të përgjithshëm (**erga omnes**) vetëm në një procedurë të kontrollit abstrakt apo konkret të kushtetutshmërisë.

Në dy rastet, megjithatë, vlen të theksohet se **ankesa kushtetuese** (e plotë ose jo e plotë) hyn në kategorinë e **mjeteve efektive juridike**, në kuptim të standardit të shterjes së mjeteve juridike të përcaktuar me **KEDNJ**, ashtu siç është interpretuar ky kusht për lejueshmëri në praktikën e **GJEDNJ**. Kjo nuk është kështu me **ankesën jo të plotë kushtetuese**: ky mjet juridik nuk përbën mjet efektiv juridik në kuptim të standardeve të **GJEDNJ**.

Ka rëndësi të shihet ngarkesa e Gjykatës Kushtetuese me lëndët që krijohen si rezultat i zbatimit të nenit 113.7 të Kushtetutës. Kjo gjendje që jepet këtu poshtë i referohet viteve të mëhershme. Ajo gjendje, megjithatë, fare nuk ka ndryshuar as sot e kësaj dite nëse shikohen proporcionet, të cilat kanë ngelur

---

[56] Janneke Gerards, "The European Court of Human Rights". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich, *Comparatiuve Constitutional Reasoning*, fq. 237-276 në fq. 239-241; Dean Spielmann, "Jurisprudence of the European Court of Human Rights and the Constitutional Systems of Europe". Në Michel Rosenfeld and András Sajó (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law* (Oxford University Press: Oxford, 2012) fq. 1231-1252 (ku autori diskuton për **KEDNJ** si për një formacion të tipit **order public** në nivel evropian, duke marrë si shembull **Britaninë e Madhe, Belgjikën, Gjermaninë** dhe **Francën**, si dhe jurisprudencën e gjykatave më të larta në këto katër vende; përveç kësaj, autori shpjegon edhe një status shumë special të **KEDNJ** si dhe marrjen e saj parasysh me rastin e interpretimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut në këto katër vende evropiane, përmes vënies në jetë të logjikës së dialogut me **GJEDNJ**; dmth nuk flitet më vetëm për "marrjen në konsideratë të **KEDNJ**, por për vënien e saj në jetë përmes dialogimit me jurisprudencën e **Strasburgut**; kjo përbën, në thelb, esencën e qasjes së Kosovës, pa çka që në rastin tonë jurisprudenca e **Strasburgut** përbën një detyrim kushtetues, kurse në këto katër vende evropiane jurisprudenca në fjalë ka një status special, jo domosdo të rangut të një detyrimi kushtetues si në **Kosovë**); Damian Chalmers, "Judicial authority and the constitutional treaty". *International Journal of Constitutional Law* Volume 3 Issue 2-3 (2005) fq. 448-472 në fq. 459, 464, 469 (ku autori përshkruan se si, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, **GJED,** paraqet arbitrin kryesor lidhur me vlerësimin nëse një akt i **BE-së** është i vlefshëm në nivel të shteteve anëtare; po ashtu, autori tregon se **Karta mbi të Drejtat Themelore e BE**-së e vitit 2000 lejon mundësinë për mbroje më të gjerë gjyqësore nga ana e vendeve anëtare dhe vetë **GJED** sepse parashikon disa standarde të kontrollit gjyqësor që bazohen në të drejta që nuk kanë qenë të qarta më herët, siç është e drejta për dinjitet njerëzor dhe e drejta e pacientit për informim paraprak para çdo procedure gjyqësore; në fund, lidhur me këto dy aspekte si më sipër, autori tregon se vetë jurisprudenca e **GJED** i ka zgjeruar horizontet e kontrollit gjyqësor duke përfshirë kategoritë juridike të të drejtave dhe lirive, siç janë mbrojtja e të dhënave, orientimi seksual dhe bioetika; ani se tërë këto të arritura në nivel të **BE**-së janë të prekshme, megjithatë, sipas autorit, nuk e ndryshojnë faktin se **KEDNJ** ende ngelet si instrumenti juridik më me peshë dhe me rëndësi të veçantë për BE-në në fushën e lirive dhe të drejatve të njeriut, si standard i kontrollit të çdo veprimi të autoriteteve publike në kontinentin evropian).

[57] Boštjan M. Zupančič, "Constitutional Law and the Jurisprudence of the European Court of Human Rights: An Attempt at a Synthesis." *REVUS. Journal for Constitutional Theory and Philosophy of Law / Revija za ustavno teorijo in filozofijo prava* Vol. 1 (2003) fq. 57-61 në fq. 58-59.

të njëjta. Kjo nënkupton që, sa i përket lirive dhe drejtave kushtetuese, të pohuara si të cenuara përmes akteve individuale të autoriteteve publike nga ana e palëve në procedurë, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës, gjendja paraqitet si vijon:

- neni 21 ["Parimet e Përgjithshme"] – 15 raste, ose 1,2 %;
- neni 22 ["Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare"] – 7 raste, ose 0,5%;
- neni 24 ["Barazia para Ligjit"] – 103 raste, ose 7,9 %;
- neni 25 ["E Drejta për Jetë"] – 1 rast, ose 0,1%;
- neni 28 ["Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues"] – 1 rast, ose 0,1%;
- neni 29 ["E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë"] – 3 raste, ose 0,2 %;
- neni 31 ["E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm"] – 368 raste, ose 28,2%;
- neni 32 ["E Drejta për Mjete Juridike"] – 5 raste, ose 0,4%;
- neni 36 ["E Drejta e Privatësisë"] – 2 raste, 0,2%;
- neni 38 ["Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë "] – 3 raste, ose 0,3%;
- neni 45 ["Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes"] – 7 raste, ose 0,5%;
- neni 46 ["Mbrojtja e Pronës"] – 359 raste, ose 27,3%;
- neni 47 ["E Drejta për Arsimin"] – 1 rast, ose 0,1%;
- neni 49 ["E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit"] – 121 raste, ose 9,3 %;
- neni 51 ["Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale"] – 89 raste, ose 6,8 %;
- neni 53 ["Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut "] – 3 raste, ose 0,2 %;
- neni 54 ["Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave"] – 21 raste, ose 1,6 %;
- shkeljet tjera – 97 raste, ose 7,4%.

Nëse statistikat si më sipër shikohen nga këndi i objektit të kontrollit kushtetues, atëherë pjesëmarrja e kontrollit kushtetues të vendimeve gjyqësore, kryesisht të **Gjykatës Supreme të Kosovës**, në ngarkesën e tërësishme të lëndëve në Gjykatë është i madh dhe zë vendin kryesor, duke marrë pjesë me përqindje të konsiderueshme. Kontrolli kushtetues i vendimeve të autoriteteve të tjera publike jashtë gjykatave, ndërkaq, deri më tani ka qenë vetëm në 64 raste, ose 4,9 %. Në rastet tjera, objekt i kontrollit kushtetues janë vendimet e gjykatave të rregullta, kryesisht të **Gjykatës Supreme**. Pse vendimet e kësaj gjykate janë kryesisht objekt kontrolli kushtetues, e sqarojmë më vonë në seksionin që flet për shterjen e mjeteve juridike dhe juridiksionin nga neni 113.7 i Kushtetutës. Në kategorinë e fundit si më sipër të 64 rasteve hyjnë kryesisht rastet që kanë të bëjnë me kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese dhe ligjeve, si dhe të akteve të tjera juridike të përgjithshme dhe të veçanta të nxjerra nga organet jo gjyqësore, si në nivel qendror ashtu dhe në atë lokal.

Sikundër shihet, thuajse afër 90 (nëntëdhjetë) për qind e kërkesave janë shpallur të papranueshme: aktgjykime nxirren vetëm në 10 (dhjetë) për qind të rasteve, tjerat shpallen si të papranueshme kryesisht për shkaqe procedurale apo mospasjes së meritave në një kërkesë. Një gjendje e tillë është e ngjashme me vendet e tjera që kanë futur në sistemin e tyre kushtetues mekanizmin e **ankesës së plotë** kushtetuese.[58] Ky mekanizëm, pra mekanizmi i **ankesës së plotë** kushtetuese, shërben si një filtër shumë serioz dhe efektiv përmes të cilit skenohet kushtetutshmëria e veprimit individual të secilit autoritet publik në Kosovë. Ky skenim është rigoroz, efektiv dhe serioz në të gjitha aspektet: në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, e cila në tërësi bazohet në precedentët e **Strasburgut**,si në çështje të vendimmarrjes materiale ashtu edhe të asaj procedurale, ekzistojnë tri baza mbi të cilat mbështetet një vendim për papranueshmëri, përkatësisht për hedhjen poshtë të një kërkese si të papranueshme.[59] Ato tri baza, **grosso modo**, janë si vijon:

- **bazat procedurale të papranueshmërisë**; në këtë grup bëjnë pjesë, ta zëmë, mosshterja

[58] *Zdeněk Kühn, " The Constitutional Court of the Czech Republic". Në* András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, *fq. 199-236 në fq. 204-207.*

[59] Cf. në tërësi shtjellimin e këtyre kritereve për pranueshmërinë e një kërkese në doracakun European Court of Human Rights, *Practical Guide on Admisibility Criteria*,

e mjeteve efektive juridike, mosrespektimi i afatit katër mujor për parashtrimin e ankesës nga data e marrjes së vendimit të fundit ndaj të cilit nuk ka më asnjë mundësi për shterje të mjeteve efektive juridike, shpërdorimi i të drejtës për ankesë, **res judicta**, si dhe rastet kur parashtruesi është anonim apo palë e paautorizuar;

- **bazat e papranueshmërisë që kanë të bëjnë me juridiksionin e Gjykatës**; në këtë grup hyn juridiksioni **ratione personae, ratione loci, ratione materiae dhe ratione temporis**;
- **papranueshmëria që ka të bëjë me meritat e rastit**; në këtë grup hyjnë situatat kur kërkesa nuk arsyetohet **prima facie**, kur faktet e paraqitura nuk arsyetojnë asnjë pretendim për shkelje kushtetuese, kur parashtruesi i ankesës nuk është viktimë e shkeljes kushtetuese dhe kur ankuesi nuk e argumenton në mënyrë të mjaftueshme kërkesën e vet.

Këto standarde, me një radhitje tjetër, janë të reflektuara në dispozitat e nenit 22 ["Procedimi i Kërkesës"] lidhur me nenet 46-50 ["Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 7 të Kushtetutës"] të **Ligjit nr. 03/L-121** dhe nenin 36 ["Kriteret e Pranueshmërisë"] të **RP**. Këto dispozita të këtyre dy akteve të përgjithshme juridike normojnë kriteret e pranueshmërisë së një kërkese të parashtruar përmes ankesës kushtetuese. Në fakt, këto dy akte juridike vetëm specifikojnë nenin 113.7 të Kushtetutës, duke pasur parasysh çdoherë standardet e vëna nga **GJEDNJ**. Në kuptim të hierarkisë, duhet pasur parasysh se kriteret e pranueshmërisë të dhëna në nenin 113.7 të Kushtetutës kanë përparësi ndaj kritereve të tjera të vendosura në dy aktet e sipër cekura. Kjo nënkupton që, në rastet kur papranueshmëria konstatohet mbi bazën e kritereve të përcaktuara kushtetuese, atëherë ankesa kushtetuese hedhet poshtë si e palejueshme.

Pa kënaqjen, përkatësisht plotësimin e këtyre kushteve të pranueshmërisë së kërkesës nuk mund të ketë vendosje meritore nga ana e Gjykatës. Ankesën e parashtruar kushtetuese hedhet poshtë si e papranueshme në rast të mosplotësimit të kritereve të pranueshmërisë si më sipër. Kësaj çështje i kthehemi sërish më vonë.

Proporcioni si më sipër në përqindje të lëndëve, sikundër u tha, pak ka gjasë të ndryshojë në jurisprudencën e Gjykatës, për aq kohë sa ekziston juridiksioni nga neni 113 i Kushtetutës. Në seksionin e tretë dhe nënseksionet e tij, në kuadër të këtij kapitulli, shtjellohet në mënyrë të detajuar juridiksioni aktual i Gjykatës.

Shpallja si e papranueshme e shumicës dërrmuese të kërkesave, sikundër shihet nga statistikat e paraqitura më sipër, ka të bëjë me procedurat e nisura me **ankesa individuale** nga qytetarët dhe nga personat e tjerë juridikë. Kjo shpallje si e papranueshme ndodhë si pasojë e mosplotësimit të kushteve të lejueshmërisë që kanë të bëjnë me objektin e kontrollit kushtetues (p.sh. për shkak se vendimi i kontestuar nuk ka marrë formën e prerë), me palët (p.sh. për shkak të mungesës së legjitimitetit aktiv të njërës palë), me vetë Gjykatën (p.sh. për shkak se mungon kompetenca kohore e saj) dhe kështu me radhë.[60]

Në jurisprudencën komparative të ish-vendeve komuniste që kanë **ankesë të plotë kushtetuese**, sipas modelit gjerman, shpallja e palejueshme e kërkesave bëhet, në shumicën dërmuese të rasteve, si pasojë e faktit se kërkesa nuk prek (ngritë) ndonjë çështje që ka relevance kushtetuese dhe, për këtë arsye, gjykata e shpallë si qartazi të pabazuar. Kjo fizionomi e gjyqësisë kushtetuese kosovare, sikur bie ndesh me konceptin themelor të **Hans Kelsenit** mbi këtë lloj të gjyqësisë, rolin dhe pozitën e saj në shoqëri. Dy gjëra **H. Kelsen** nuk do t'i kishte menduar kurrë, megjithatë: **ankesën kushtetuese** dhe **ligjvënësin pozitiv**. Këto dy segmente, në fakt, sot janë standard i gjyqësisë kushtetuese. Kosova nuk është e vetëm në këtë drejtim: të gjitha vendet e reja ish–komuniste kanë ndjekur këtë rrugë duke parashikuar një juridiksion mjaft të gjerë dhe duke e parë këtë si një domosdoshmëri të ecjes së tyre përpara kah modelet

[60] Sa i përket gjendjes në vendet e tjera ish-komuniste, cf. më shumë në: Wojciech Sadurski, "Constitutional Justice, East and West: An Introduction". Në Wojciech Sadurski (ed), *Constitutional Justice, East and West,* fq. 1-18; John Ferejohn and Pasquale Pasquino, "Constitutional Courts as Deliberative Institutions: Towards an Institutional Theory of Constitutional Justice". Në Wojciech Sadurski (ed), *Constitutional Justice, East and West,* fq. 21-36.

e demokracive liberale kushtetuese. Ky evoluim i konceptit kelsenian të gjyqësisë kushtetuese ka një histori të vet, që duhet ta tregojmë me këtë rast.

E përbashkët në këtë evoluim të gjyqësisë kushtetuese bashkëkohore është ndryshimi i natyrës juridike të kushtetutave. Pas **Luftës së Dytë Botërore**, kushtetutat më nuk shihen si dokumente programatike dhe propagandistike, pa asnjë vlerë apo fuqi normative me qëllim të zbatimit të tyre në praktikë. E thënë me fjalë të tjera, kushtetuta në këtë evoluim gjithnjë e më shumë nisin të shihet si dokumente me vlerë të madhe normative që duhet të zbatohen si çdo ligj apo akt tjetër normativ i natyrës së përgjithshme. Kushtetutat nacionale tanimë nuk shihen vetëm si grumbull i dispozitave mbi rregullat e organizimit dhe funksionimit të pushtetit shtetëror, por si tërësi normash që definojnë origjinën dhe natyrën e pushtetit shtetëror, mënyrën e organizimit dhe ushtrimit të tij dhe, mbi të gjitha, si tërësi rregullash që përcaktojnë saktësisht rolin dhe pozitën e individit në shoqëri, duke ofruar garancione të forta kushtetuese të këtij roli dhe pozite që mund të vihen në jetë përmes mekanizmave gjyqësor. Si çdo evolucion, edhe ky ka përshkuar një rrugë të gjatë dhe të mundshme. Si i tillë, ai nis me **Kushtetutën e Belgjikës (1831)**, ndërpritet me revolucionet e vitit 1848 dhe promovimin e pozitivizmit juridik gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX. Pas **Luftës së Parë Botërore, Kushtetuta e Vajmarit** (1919) ringjallë konceptin liberalo-social mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, duke parashikuar një katalog të gjerë të lirive dhe të drejtave njerëzore në kapitullin e saj të dytë, ani se ky kapitull më shumë ka pasur vlerën e parimeve drejtuese pa ndonjë fuqi normative.[61] Kjo për shkak se **Republika e Vajmarit** nuk ka qenë në gjendje të sigurojë normativitetin dhe efektivitetin e të drejtave të garantuara, e as mbrojtjen e kushtetutës së vet si tërësi. Jashtë rrugëve të rregullta gjyqësore, liritë dhe të drejtat kushtetuese të qytetarëve gjermanë nuk kanë gëzuar asnjë formë tjetër të mbrojtjes së specializuar apo të veçantë.[62]

Kushtetuta e Belgjikës e vitit 1831 dhe disa kushtetuta jetëshkurtra evropiane të vitit 1848 patën provuar e koncepteve liberale mbi të drejtat e njeriut nëpër dispozitat e tyre. Në fakt, **Kushtetuta e Belgjikës** kishte një katalog mbi të drejtat e belgjikanëve. Kjo, megjithatë, nuk pat ndonjë sukses. Gjysma e dytë e shekullit XIX u dominua nga **pozitivizmi**, që theksonte se të drejtat dhe liritë e njeriut nuk mund të ishin natyrore dhe parashtetërore, por duhej të ishin qartë të përcaktuara nga shteti me kushtetutë e ligje. Çdo liri dhe e drejtë njerëzore kuptohej si diçka që shteti duhej ta përcaktojë, gjë që nënkuptonte se ato ishin në mëshirën e fuqisë rregullative të shtetit të gjithëpushtetshëm.[63] Me lindjen e katalogut të të drejtave të njeriut si kategori kushtetuese, që filloi në mënyrë të qartë me **Kushtetutën e Vajmarit**, u vazhdua tradita e nisur me **Kushtetutën e Belgjikës** të vitit 1831. Në mënyrë graduale u bë e domosdoshme të krijohet edhe një mekanizëm institucional për vënien në jetë të përmbajtjes normative kartave mbi të drejtat e njeriut. Kjo gjë u pa si e domosdoshme në veçanti pas **Luftës së Dytë Botërore**, e edhe më në veçanti pas rënies së komunizmit si sistem shtetëror (1990).[64]

Në këtë kohë, kushtetutat nacionale në mënyrë graduale futën në dispozitat e tyre normat mbi të drejtat e njeriut si dhe mekanizmat përkatës institucionalë për vënien e tyre në jetë, në rend të parë **ankesën kushtetuese**, të cilën qytetarët mund ta përdorin për realizimin e të drejtave e lirive të tyre të garantuara

---

61 Michaela Hailbronner and Stefan Martini,"The German Constitutional Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 356-393 në fq. 357; Nigel Foster & Satish Sule, *German Legal System and Laws*. Fourth Edition (Oxford University Press: Oxford, 2010) fq. 221.

62 Dragan M. Stojanovic, *Ustavno pravo*. Knjiga I (Bona Fides: Nis, 2001) fq. 340; Nigel Foster & Satish Sule, *German Legal System and Laws*, fq. 221.

63 Dragan M. Stojanovic, *Ustavno pravo*, fq. 329-335 (ku autori gjerësisht flet për rrymat kushtetuese liberale dhe përvojat e **Blegjikës** dhe disa vendeve tjera me garantimin kushtetues të lirive dhe të drejtave njerëzore; lindjen e pozitivizmit në gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe pasojat e tij për konstitutcionalizmin evropian; dhe, në fund, për lindjen e konceptit kolektivist sovjetik (socialist) mbi liritë dhe të drejtat e njeriut pas **Luftës së Parë Botërore**.

64 Për një histori mjaft të detajuar të këtij evoluimi, cf. Gustavo Zagrebelsky & Valeria Marceno, *Giustizia costituzionale* (Il Mulino: Bologna, 2012) fq. 15-64; Për dinamikat e viteve të para pas rrënimit të komunizmit dhe themelimit të gjyqësisë kushtetuese nëpër vendet ish komuniste, cf. Jean-Pierre Massias, *Droit constitutionel des Etats d'Europe de l'Est* (Press Universitaire de France: Paris, 199) fq. 13-63; Levent Gonenc, *Prospects for Constitutionalism in Post-Communist Countries* (Martinus Nijhoff Publishers: The Hague, 2002) fq. 250-259 & 264-268.

me kushtetutë. Këtu gjithmonë e kemi fjalën për rastet e kushtetutave që sanksionojnë **ankesën e plotë kushtetuese**, pra ankesën që është mjet efektiv juridik përmes të cilit mund të adresohet dhe përmirësohet (ndreqet) në mënyrë efektive çdo cenim i lirive dhe të drejtave kushtetuese i bërë në procedurat paraprake pranë autoriteteve të tjera publike.

Mekanizmi i **ankesës kushtetuese** ka një kohë që paraqet një mjet të fuqishëm juridik. Ai, megjithatë, ngelet një aspekt shumë pak i theksuar në diskursin publik, në krahasim me një cilësi tjetër themelore të gjyqësisë kushtetuese. Kësaj cilësie i kthehemi në vijim, për një arsye fare të thjeshtë: ajo ka qenë e vërejtshme dhe definuese, duke ekzistuar që nga lindja e profesionit të gjyqësisë kushtetuese në mes të dy luftërave botërore. E kemi fjalën për **kontrollin abstrakt** të kushtetutshmërisë së normave juridike, i cili ka qenë dhe ngelet shenja dalluese e këtij aktiviteti shtetëror. Si i tillë, kontrolli abstrakt i normave juridike përbën cilësinë dalluese **prima facie** të gjyqësisë kushtetuese, që e dallon atë nga gjyqësori i rregullt dhe nga çdo aktivitet tjetër shtetëror. **Kontrolli abstrakt i normave juridike ende mbetet kryefjala e të gjitha kushtetutave nacionale kur bëhet fjalë për definimin e gjyqësisë kushtetuese, për rolin dhe për funksionin e saj primar, sado që ankesat individuale përbëjnë ngarkesën dërrmuese të punës së gjykatave kushtetuese**.

Kosova dhe gjyqësia e saj kushtetuese, megjithë që i takojnë modelit klasik **evropian/kelsenian**, kanë disa specifika që lidhen historinë e vetë sistemit kushtetues kosovar, një sistem që në ndërtim e sipër ka pësuar disa kufizime të natyrave të nduarnduarshme. Në to hyjnë edhe kufizimet e sovranitetit gjyqësor, përfshirë kufizimet në sovranitetin e mbrojtjes së Kushtetutës. Në vijim diskutojmë vetëm kufizimet ndaj ushtrimit të juridiksionit të saj kushtetues nga neni 113 i Kushtetutës. Ato deri më sot kanë qenë të dyllojta: njëri lloj ka vlejtur për kohën sa ka zgjatur pavarësia e ur (2008-2012) dhe lidhet me statusin superior të **Planit Ahtisari**, kurse tjetri vazhdon të jetë në fuqi dhe ka të bëj rolin dhe pozitën e **Gjykatës Speciale**. Si në rastin e parë, ashtu dhe në të dytin, kufizimet e juridiksionit nga neni 113 i Kushtetutës kanë qenë dhe janë gjithëpërfshirëse, duke ngërthyer të gjitha llojet e kompetencave të natyrës materiale (**ratione materiae**), kohore (**ratione temporis)**, vendore (**ratione loci)** dhe personale (**ratione personae).** Këto janë çështjet që i trajtojmë në hollësi në seksionin në vijim.

11.2. Juridiksioni i kufizuar i Gjykatës Kushtetuese (gjatë pavarësisë së ur dhe pas themelimit të Gjykatës Speciale)

Kufizimi i juridiksionit të Gjykatës që ka ndodhur gjatë kohës së pavarësisë së ur ka pasur të bëjë me kufizimet si pasojë e ekzistimit të dispozitave specifike të natyrës së përkohshme në të drejtën kushtetuese pozitive të Kosovë së asaj kohe. Kjo periudhë ka zgjatur deri në vitin 2012, vit në të cilin janë shfuqizuar dispozitat e Kushtetutës që i jepnin supremaci (epërsi) absolute dispozitave të Planit. Këto lloje të kufizimeve kanë qenë imanencë e faktit të thjeshtë se Kushtetuta është derivat i drejtpërdrejtë i Planit, jo anasjelltas. Për pasojë, supremacia (epërsia) e Kushtetutës nuk ka mundur të vijë në shprehje. Siç e kemi theksuar në kapitullin pararendës, normat kushtetuese dhe praktikat kushtetuese është dashur të jenë në harmoni me Planin.[65] Kjo gjë është reflektuar si në juridiksionin e Gjykatës ashtu dhe në vetë përbërjen e saj. Për përbërjen e saj flasim gjetiu më vonë, kurse në vijim

[65] Kapitulli XIII [Dispozitat Përfundimtare] i Kushtetutës:
Neni 143 [**Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës**]
"Pavarësisht dispozitave tjera të kësaj Kushtetute:
1. Të gjitha autoritetet në Republikën e Kosovës veprojnë në pajtim me të gjitha detyrimet e Republikës së Kosovës sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007. Ato do të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e tyre.
2. Dispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007, kanë epërsi ndaj të gjitha dispozitave të tjera ligjore në Kosovë.
3. Kushtetuta, ligjet dhe aktet tjera ligjore të Republikës së Kosovës interpretohen në pajtueshmëri me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007. Në rast se ka papajtueshmëri midis dispozitave të kësaj Kushtetute, ligjeve dhe akteve të tjera ligjore të Republikës së Kosovës dhe dispozitave të marrëveshjes, kjo e fundit do të mbizotërojë."

flasim për juridiksionin dhe kufizimet e tij të natyrës si më sipër, gjatë kohës sa ka zgjatur pavarësia e ur, për të vazhduar më pas me situatën e krijuar me themelimin e Gjykatës Speciale.

Kjo mund të cilësohet si periudha e supremacisë (epërsisë) së përkohshme e Planit. Në këtë kohë, kjo supremaci (epërsi) është siguruar nga organet vendore, në rend të parë nga Gjykata Kushtetuese, e cila ka pasur në gjirin e saj tre gjyqtarë ndërkombëtarë. Në fakt, ka qenë detyrim kushtetues i Gjykatës për të siguruar këtë supremaci (epërsi). Nëse ajo nuk do ta bënte një gjë të tillë, interpretimi i saj përfundimtar bëhej nga autoritetet ndërkombëtare të caktuara sipas Planit.[66] Kjo nënkupton se interpretimi i Plani dhe kontrolli i kushtetutshmërisë bëheshin në harmoni më dispozitat e këtij dokumenti ndërkombëtar.

Nëse shikohen gjashtë rastet e vendosura nga Gjykata, në të cilat objekt trajtimi ka qenë fuqia absolute juridike e Planit, atëherë qartë vërehet se vetëm njëri nga to është i vitit 2016. Të tjerat janë të kohës sa ka zgjatur pavarësia e kufizuar e Kosovës. Në vijim analizojmë secilin prej gjashtë rasteve në të cilat Plani ka qenë alfa dhe omega e vendimit të Gjykatës.

Në rastin e parë, i cili ka pasur të bëjë me çështje pronësore, ankuesi ka kërkuar nga Gjykata që t'ia rikthejë pronësinë, duke zbatuar ligjin e aplikueshëm në Kosovë në çështjet e shpronësimit. Nga pretendimet e ankuesit vërehet se ai ka pohuar ankime të natyrës faktike që i takojnë organeve të shkallës së parë, gjykatave dhe organeve administrative që kishin vendosur se toka e shpronësuar në vitet '50 të shekullit të kaluar nuk mund të rikthehej për shkak të mungesës së një ligji për rikthim të pronave dhe kompensim të shpronësimeve të kryera në të kaluarën. Në arsyetimin e saj, Gjykata ka konstatuar supremacinë (epërsinë) e **Planit Ahtisari**, i cili ia kishte vënë si detyrim Kosovës nxjerrjen e ligjit për kthim të pronave dhe normimin e kësaj çështje në mënyrë gjithëpërfshirëse, diçka që asnjëherë deri më sot nuk është bërë. Kjo rrethanë qe përdorur nga organet administrative lokale dhe qendrore, me plot të drejtë, si një bazë për refuzim të kërkesës për kthim të tokës ankuesit. Mosnxjerrja e ligjit për kthim të pronave të marra nga proceset e shpronësimit në ish-Jugosllavi e bën kategorinë kushtetuese të pronës në Kosovë të paefekt për një kategori të caktuar të personave. Në fakt, **Kosova** është i vetmi vend ish-komunist në **Evropë** që këtë çështje nuk e ka rregulluar. Gjykata, megjithatë, si bazë për refuzim të kërkesës së ankuesit gjeti mosshterjen e mjeteve juridike dhe faktin që ankuesi nuk kishte arsyetuar si duhet kërkesën e vet për shkeljet e pohuara kushtetuese.[67]

Vendimi tjetër me radhë i Gjykatës, sërish lidhur me kthimin e pronës së konfiskuar pas **Luftës së Dytë Botërore**, në mënyrë edhe më specifike ia njeh fuqinë sipërore juridike Planit kundrejt çdo dokumenti tjetër juridik kosovar gjatë kohës së pavarësisë së ur. Në këtë vendim, Gjykata në mënyrë specifike flet, për herë të dytë, për lëshimin (**ometimin**) kushtetues, si një shkelje kushtetuese që ka kryer Kuvendi i Kosovës me mosnxjerrjen e ligjit për kthim të pronave në Kosovë. Ky detyrim për

---

66 Kapitulli XIV [Dispozitat Kalimtare] i Kushtetutës
"Neni 146 [**Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil**]
Pavarësisht dispozitave tjera të kësaj Kushtetute:
1. Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil dhe organizatat e akterët e tjerë ndërkombëtarë të mandatuar sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, kanë mandatin dhe kompetencat e përcaktuara me Propozimit Gjithëpërfshirës, duke përfshirë zotësinë juridike si dhe privilegjet dhe imunitetet e përcaktuara me të.
2. Të gjitha autoritetet në Republikën e Kosovës bashkëpunojnë plotësisht me Përfaqësuesin Ndërkombëtarë Civil, organizatat dhe akterët tjerë ndërkombëtarë të mandatuar sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, dhe, ndër të tjera, i'u japin fuqi ligjore vendimeve ose akteve të tyre.
Neni 147 [**Autoriteti Përfundimtar i Përfaqësuesit Ndërkombëtarë Civil**]
Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj Kushtetute, Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil, në pajtim me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, është autoriteti përfundimtar në Kosovë lidhur me interpretimin e aspekteve civile të Propozimit Gjithëpërfshirës. Asnjë autoritet i Republikës së Kosovës nuk ka jurisdiksion të rishikojë, të pakësojë ose në ndonjë mënyrë të kufizojë mandatin, kompetencat dhe detyrimet e përcaktuara në nenin 146 dhe në këtë nen."

67 Cf. *Rasti KI 02/09. Vendim për Papranueshmëri.Parashtruesi i kërkesës. Kole Krasniqi nga Gjakova. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të Ministrisë së Bujqësisë nr. 2324 të datës 22 shtator 2009 dhe vendimit të Drejtorisë së Çështjeve Pronësore-Juridike dhe Rregullimin e Tokes të Komunës së Gjakovës nr. 9-463-8/91-08 të datës 20 nëntor 2008*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Ref.: Nr. RK-02/10. Prishtinë: datë 26 janar 2010. Paragrafet.

veprim i Kuvendit ka qenë një ndër detyrimet e Kosovës të marra në bazë të nenit 6.1 ["Restituimi i Pronës"] të Aneksit VII ["Prona dhe Arkivi"] të Planit. Në këtë frymë kishin qenë edhe vendimet e gjykatave të tjera të rregullta të cilat sfidoheshin me ankesë kushtetuese dhe të cilat kishin refuzuar kërkesën e palëve për shqyrtim të meritave të rastit.[68]

Vendimi i tretë ka të bëjë me rastin e **AKP**-së, të cilin e kemi diskutuar më sipër. Ky vendim nuk ka të bëjë aq shumë me supremacinë e Planit, sa me vënien e një barazimi në mes të tij dhe Kushtetutës së vitit 2008. Këtu Gjykata ka mbrojtur tezën se **funksioni nomofilatik** i **Gjykatës Supreme**, pjesë e së cilës ishte **Dhoma e Posaçme**, përcaktohej në mënyrë të njëjtë në **Planin Ahtisari** dhe në Kushtetutën e vitit 2008. Këtë tezë, pra se Gjykata Supreme ka për detyrë që të sigurojë zbatimit e njëtrajtshëm të ligjeve në tërë territorin e Kosovës, Gjykata Kushtetuese e mbrojti jo duke u mbështetur në supremacinë (epërsinë) e Planit, por në **Mendimin e GJND për Kosovën**. Konstatimi i supremacisë (epërsisë) së Mendimit u mbështet në dispozitat e Kushtetutës së vitit 2008, të cilat flasin për detyrimin e Kosovës për të respektuar të drejtën ndërkombëtare në tërësinë e saj, në ndërkohë që vetë supremacia (epërsia) e Planit ishte shtjelluar ekskluzivisht në kontekstin e përbërjes së trupit gjykues në fazën e apelit pranë **Dhomës së Posaçme**, çështje që këtu nuk ka ndonjë peshë të madhe për ta trajtuar më thellë.[69]

Vendimi i katërt që lidhet me Planin paraqet pikën kthesë në sigurimin e supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës së vitit 2008. Ky vendim ka të bëjë me kontrollin kushtetues të amendamenteve me të cilat përfundonte pavarësia e mbikëqyrur e Kosovës dhe fshiheshin nenet përkatëse të Kushtetutës që garantonin epërsinë (supremacinë) e **Planit Ahtisari**. Bëhet fjalë për fshirjen e neneve 146 ["Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar"] dhe 147 ["Autoriteti Përfundimtarë i Përfaqësuesit Ndërkombëtarë Civil"] të Kushtetutës, me të cilat normohej mandati, kompetencat dhe obligimet e **PCN**-së.

Këtu kanë qenë gjithsej 22 (njëzetë e dy) amendamente, të cilat iu janë nënshtruar kontrollit kushtetues nga Gjykata. Me këto amendamente, Kushtetuta e vitit 2008, praktikisht ngel akti suprem (sipëror) në vend. Në këtë grup të amendamenteve përfshihen edhe dispozitat e saj me që kanë karakter ndërkombëtar, por që janë futur në te si norma kushtetuese, siç është rasti me normat ndërkombëtare të kthyera në norma kushtetuese përmes nenit 22 ["Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare"] të Kushtetutës. Këtë e ka konfirmuar Gjykata kur ka gjetur se vetëm një amendament nga 22 (njëzetë e dy) amendament e propozuara mund të zvogëlojë të drejtat dhe liritë e garantuara kushtetuese, gjithnjë me supozim se ai do të miratohej në **Kuvend të Kosovës**. Ky amendament, amendamenti i propozuar nr. 17, ka pasur të bëjë me refugjatët dhe personat e zhvendosur dhe propozonte fshirjen e nenit 156 ["Refugjatet dhe Personat e Zhvendosur Brenda Vendit"] të Kushtetutës, diçka që Gjykata gjeti si pakësim të lirive dhe të drejtave kushtetuese. Kjo ishte kështu për shkak se, sipas Gjykatës, detyrimet ndërkombëtare të **Kosovës** lidhur me refugjatët dhe personat e zhvendosur kishin fuqi sipërore dhe detyronin **Kosovën** për ndërmarrjen e masave dhe veprimeve të caktuara për vënien e tyre në jetë me qëllim të mbrojtjes së këtyre dy kategorive të personave dhe të drejtave e lirive të tyre kushtetuese. Kjo do të thotë se Gjykata i kishte vënë detyrimet ndërkombëtare të Kosovës, ashtu siç janë bartur ato në normën kushtetuese nga neni 22 i Kushtetutës, në kuadër të detyrimeve kushtetuese që kanë fuqi juridike të barabartë me çdo detyrim tjetër që buron nga ajo.[70]

Vendimi në vijim, i parafundit, i Gjykatës që ka përdorur Planin si bazë juridike për vendosje nuk ka ndonjë peshë të madhe sa i përket rolit dhe rëndësisë së tij në rendin juridik- kushtetues kosovar gjatë kohës sa ka zgjatur pavarësia e mbikëqyrur e Kosovës. Në këtë vendim vetëm parashtruesi i kërkesës

---

68 Cf. *Rasti KI 14/09. Vendim për Papranueshmëri.Trashëgimtarët e Ymer Loxhes dhe Sehit Loxhes kunder Vendimit Nr. PKL. Nr. 21/07 te Gjykates Supreme te Republikes se Kosoves, i dates 17 dhjetor 2008.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Ref. Nr.: RK 47/10.Prishtine: 15 tetor 2010. Paragrafët. 28-33.

69 Cf. *Rasti KI 25/10. Aktgjykim,* paragrafët 34-35, 41, 54-63, 65, 67.

70 *Rasti KO 38/12. Aktgjykim. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Propozimeve te Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës, të dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës më 12 prill 2012.***Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Nr. ref.: AK 234 /12. Prishtinë, më 15 maj 2012. Paragrafet 15-16, 50-55, 80-93, si dhe pika II e pjesës operative të aktgjykimit.

dhe palët që potencialisht ishin të interesuara për rastin kanë bazuar pretendimet e tyre reciproke në Planin Ahtisari, në ndërkohë që vetë Gjykata ka vendimin e ka bazuar në dispozitat kushtetuese dhe në jurisprudencën komparative. Si palë të interesuara që kanë dhënë komentet e tyre në këtë rast kanë qenë. **Kisha Ortodokse Serbe**, **Kisha Katolike**, **Bashkësia Islame e Kosovës** dhe **PCN**-ja. Vetë rasti, ndërkaq, ka pasur të bëjë me kontrollin kushtetues të dy ligjeve me rëndësi të veçantë për trashëgiminë kulturore dhe fetare të komuniteteve të Kosovës, **Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe** dhe të **Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit**. Aplikuesit, 12 deputetë të Kuvendit të Kosovës, kanë kërkuar që të vlerësohet kushtetutshmëria e dispozitave të këtyre dy ligjeve që normojnë **laicitetin** dhe **neutralitetin e autoriteteve publike në çështjet fetare**, barazinë para ligjit dhe autonominë komunale. Në këtë kontekst ata kërkuan që, krahas Kushtetutës së vitit 2008, të afirmohej supremacia (epërsia) e Planit, që ende ishte në fuqi në atë kohë. Palët e interesuara, Përveç **PCN**-së, po ashtu kishin dhënë përgjigje në kërkesën e aplikuesve. Edhe ato kishin mbështetur supremacinë (epërsinë) e Planit, duke theksuar fuqishëm se të drejtat dhe liritë e tyre kulturore e fetare buronin në rend të parë nga garancionet e dhëna nga vetë ai, të cilat më pastaj janë bartur në kapitullin e tretë të Kushtetutës së vitit 2008, si pjesë e detyrimeve ndërkombëtare të Kosovës për të respektuar diversitetin etnik, kulturor, fetar, gjuhësor dhe tjetër**. PCN**-ja nuk dha asnjë koment si palë e interesuar sepse bëhej fjalë për një çështje në të cilën sigurimi i supremacisë (epërsisë) së Planit përbënte përgjegjësinë e tij kryesore gjatë kohës sa ka zgjatur pavarësia e mbikëqyrur.

Kërkesa u hodh poshtë si e palejueshme nga Gjykata, duke konfirmuar se ligjet si më sipër ishin në tërsi në pajtim me Kushtetutën. Në arsyetimin e vet, megjithatë, Gjykata nuk u mbështet fare në **Planin Ahtisari**, siç kishin kërkuar palët dhe vetë aplikuesi. Një gjë e tillë, në fakt, nuk kishte nevojë të bëhej sepse dispozitat e kapitullit të tretë të kushtetutës janë mjaftueshëm të qarta dhe, në lidhshmëri me dispozitat tjera që kanë të bëjnë për laicitetin, barazinë para ligjit dhe autonominë lokale, sigurojnë gjerësisht supremacinë (epërsinë) e germës dhe frymës së Planit, fakt që konstatohet edhe vetë Gjykata në këtë vendim kur i referohet kapitullit në fjalë të Kushtetutës.[71] Kjo është kështu edhe sot e kësaj dite: amendamentet e cekura më sipër, kushtetutshmërinë e të cilëve e kishte konfirmuar Gjykata me aktgjykim (në rastin **K0 38/12)**, nuk bënë asgjë pos që konstitucionalizuan germën dhe frymën e Planit në çështjet që kanë të bëjnë me diversitetin etnik, fetar, gjuhësor, kulturor dhe tjetër që ekziston në Kosovë.

Ky konstitucionalizim i frymës dhe germës është shtrirë edhe në lëmin e vetëqeverisjes lokale: kapitulli X ["Qeverisja Lokale dhe Organizimi Territorial"] i Kushtetutës nuk është asgjë tjetër pos rikonfirmim i frymë dhe germës së dispozitave të aneksit III ["Decentralizimi"] të Planit, të cilat më tutje janë shtjelluar me **Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale** (datë 20 shkurt 2008).[72] Se kjo është kështu është konfirmuar nga një vendim i vonshëm i Gjykatës Kushtetuese, i gjashti dhe i fundit nga grupi i vendimeve që shtjellojnë dispozitat e Planit.[73]

Në këtë vendim, që ka të bëjë me kontrollin e kushtetutshmërisë së **Ligjit për Trepçën**, Gjykata ka vendosur vetëm në bazë të Kushtetutës së vitit 2008, përkundër faktit se parashtruesit e kërkesës kishin bazuar kërkesën e tyre edhe në **Planin Ahtisari**. Gjykata këtu bëri anashkalim duke mos marrë Planin si bazë për vendimmarrje. Kjo për shkak se dispozitat përkatëse të tij lidhur me rolin dhe rëndësinë e komunave në sistemin kushtetues kosovar janë integruar në kapitullin e dhjetë të Kushtetutës së vitit

---

71 Cf. Paragrafi 66. "[…] Ky Kapitull përmban të drejta specifike t'u jepen grupeve kombëtare, etnike, gjuhësore dhe fetare përveç; te drejtave te para para ne Kapitullin II. Gjykata duhet t'i shqyrtojë te gjitha dispozitat kushtetuese se bashku e jo te mbështetet vetëm ne një me rastin e interpretimit te Kushtetutës". *Rastet K0 45/12 dhe K0 46/12. Aktgjykim. Kërkesa e Liburn Aliut dhe 11 deputeteve te tjerë te Kuvendit te Republikës së Kosovës për vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit për fshatin Hocë e Madhe dhe te Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr.Ref.:AGJ 255/12.Prishtine: 25 qershor 2012 Cf. Po ashtu edhe paragrafët 6-8, 19-20, 22, 28, 32, 34-41, 43-47, 49-55, 58, 65-66 të aktgjykimit.

72 *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* nr. 28/2008 e datës 4 qershor 2008

73 *Rasti KO 120/16. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Slavko Simic dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë se Ligjit nr. 05/L-079 per Investimet Strategjike ne Republikën e Kosovës.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës** Nr. ref.: RK 1034/17. Prishtinë, më 1 shkurt 2017.

2008, përfshirë dispozitat lidhur me rolin dhe rëndësinë e ruajtjes së diversitetit etnik, fetar, gjuhësor, kulturor dhe tjetër në nivel lokal. Dhe, në fund, në dispozitat e këtij kapitulli, në mënyrë shprehimore parashikohet edhe zbatimi i drejtpërdrejtë i **Konvent*ë*s Evropiane p*ë*r Vetëqeverisje Lokale**.[74] Se kjo që u tha është e saktë, kuptohet në mënyrë shumë të qartë nëse analizohet vendimi i Gjykatës, dispozitat kushtetuese të kapitullit të dhjetë si dhe aktet ligjore dhe ndërkombëtare që rregullojnë vetëqeverisjen lokale në **Kosovë.**[75]

Kufizimi i dytë në juridiksionin e **Gjykatës Kushtetuese** është më dramatik sepse ka një natyrë tjetër që prek në mënyrë të drejtpërdrejtë normat procedurale mbi juridiksionin e saj. Ky kufizim ka lindur ka lindur me themelimin e **Gjykatës Speciale**, pas mbarimit të pavarësisë së mbikëqyrur në shtator të vitit 2012. Atëbotë, sikur u duk që **Gjykata Kushtetuese** do të rikthejë në plotni juridiksionin e saj të garantuar me nenin 113 ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] të Kushtetutës. Kjo, megjithatë, nuk ndodhi: në ndërkohë që vendi po përgatitej për heqjen qafe të kufizimeve të vetimponuara në ushtrimin e kompetencave të një shteti sovran dhe të pavarur, në publik doli një akuzë e rëndë nga një prokuror zviceran, i njohur si raporti **Dik Marti**. Ky raport u miratua nga **Asambleja e Parlamentare e Këshillit të Evropës (AP e KE).**

Bazuar në autorizimet kushtetuese, organi përfaqësues i Kosovës mori përsipër zotimin për ta vënë në jetë këtë raport dhe për të nisur hetimet speciale për konstatimin e vërtetësisë së akuzave të bëra nga **Dik Marti** lidhur me krimet e kryera në **Kosovës** gjatë luftës dhe në vitin e parë pas mbarimit të saj. Organet tjera, presidenti dhe qeveria, ndoqën këtë zotim të Kuvendit.[76] Krimet për të cilat u kryen hetimet e që në fund çuan në themelimin e **Gjykatës Speciale**, në rend të parë kanë të bëjnë me krimet e luftës dhe me krimet kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare. Veç tyre, Gjykata do të ketë juridiksion edhe ndaj krimeve të tjera që nuk kanë këtë natyrë dhe që janë të ndëshkueshme sipas legjislacionit penal të **Kosovës**, i cili ka qenë në fuqi pas luftës e deri në mbarim të vitit 2000.[77]

Vlen të theksohet se Gjykata është pjesë integrale e sistemit kushtetues kosovar dhe bën pjesë në hierarkinë vertikale të sistemit gjyqësor kosovar, me një subjektivitet dhe pavarësi të plotë nga të gjitha nivelet ekzistuese gjyqësore dhe nivelit tjera të pushtetit vendor.[78]

Vendimmarrja në Gjykatë kryhet nga panelet prej tre gjyqtarëve.[79] Në rastet kur krimet nuk kualifikohen si krime të rënda, ato mund të gjykohen nga një gjyqtar i vetëm.[80] Të gjithë gjyqtarët e saj kanë status të gjyqtarëve ndërkombëtarë: vendorët nuk mund të shërbejnë si gjyqtarë në këtë gjykatë.[81] Ata përzgjidhen nga një panel përzgjedhës që formon listën e shkurtër, listë që më pastaj i paraqitet "[…] Kreut të

---

74 "European Charter of Local Self-Government". *European Treaty Series* No. 122 (Strasburg: 15. X. 1985).

75 Cf. paragrafet 4-7, 42-43, 50-52, 68, 72-77, 124-129 të *rastit KO 120/16. Aktvendim për Papranueshmëri*.

76 Cf. fusnotat nr**. 78-79**, **infra**, si dhe komentet tona lidhur me te.

77 Kjo normohet me **Ligjin Nr. 05/L -053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar**, datë 3 gusht 2015. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*. Nr. 20. Prishtinë: datë 5 gusht 2015. Cf. nenet 12 ["Ligji i zbatueshëm"], 13 ["Krimet Kundër Njerëzimit sipas së Drejtës Ndërkombëtare"], 14 ["Krimet e Luftës sipas së Drejtës Ndërkombëtare"] dhe neni ["Krime të tjera sipas së drejtës së Kosovës"] të këtij ligji.

78 **Ligji Nr. 05/L -053,** neni Neni 3 ["Parimet themeluese"]:
"1. Dhomat e specializuara janë pjesë përbërëse e çdo niveli të sistemit të gjykatave në Kosovë: Gjykatës Themelore të Prishtinës, Gjykatës së Apelit, Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Kushtetuese. Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese do të merret ekskluzivisht me referimet kushtetuese lidhur me Dhomat e Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Dhomat e Specializuara janë të pavarura në ushtrimin e funksioneve të tyre. […]". Për komentet, cf. Fisnik Korenica, Argjend Zhubi, Dren Doli, "The EU-engineered hybrid and international specialist court in Kosovo: How 'special' is it? *European Constitutional Law Review* Vol. 12 Issue 3 (December 2016), fq. 474–498 në fq. 485-487

79 Përveç paneleve vendimmarrëse si më sipër, në **Gjykatën Speciale** ekzistojnë edhe **Zyra e Prokurorit të Specializuar** dhe **Zyra Administrative**. Në kuadër të kësaj të fundit gjenden. **Zyra për Pjesëmarrjen e Viktimave**, **Zyra për Mbrojtjen e Specializuar**, **Zyrën për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve** dhe **Zyra e Ombudspersonit**. Cf. neni 34. (6-9) ["Zyra Administrative"] i **Ligjit Nr. 05/L -053.**

80 Cf. neni 25.1 & 2 ["Përbërja e dhomave"] i **Ligji Nr. 05/L -053;**

81 Cf. neni 26.1 ["Regjistri i gjyqtarëve ndërkombëtarë"] i **Ligji Nr. 05/L -053.**

të Misionit të BE-së për Siguri të Përbashkët dhe Mbrojtje ("Autoriteti Emërues") si rekomandime për emërimin e gjyqtarëve të Dhomave të specializuara në Regjistrin e Gjyqtarëve Ndërkombëtarë".[82] Kriteret për përzgjedhjen e tyre janë të njejta me ato që vlejnë për caktimin e gjyqtarëve në gjykatat e larta në vendet nga vijnë, mirëpo në përbërjen e përgjithshme të regjistrit të gjyqtarëve ndërkombëtarë kujdes i duhur i kushtohet aftësive të konsoliduara dhe përvojës së gjyqtarëve në të drejtën dhe procedurën penale dhe të drejtën ndërkombëtare. Si një kusht shtesë për kualifikim është edhe aftësia e gjyqtarëve në fjalë për të komunikuar rrjedhshëm në gjuhën angleze.[83] E njëjta vlen edhe për gjyqtarët kushtetues të kësaj gjykate,[84] gjë që është krejt e natyrshme për shkak të specifikave të fizionomisë së saj si një gjykatë nacionale tërësisht e internacionalizuar, si dhe të vetë juridiksionit të saj të specializuar.

Zotimi si më sipër i **Kuvendit të Kosovës** për themelimin e Gjykatës, krahas zotimit të marrë njëanshëm nga **Kosova** me rastin e shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt 2008, i shprehur përmes **Deklaratës së Pavarësisë**, përbën një detyrim shtesë ndërkombëtar për vendin. Në vijim të zbatimit të këtij detyrimi ndërkombëtar, këtë herë të marrë me vullnet të shprehur në planin bilateral, **Kosova** hyri në disa marrëveshje ndërkombëtare dhe nxori një ligj për vënien në jetë të zotimit për themelimin e kësaj Gjykate. Kjo bëri që të kufizohet në mënyrë të dukshme juridiksioni i **Gjykatës Kushtetuese**: në këtë gjykatë kaluan të gjitha kompetencat juridiksionale nga neni 113 ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] të Kushtetutës që kanë të bëjnë me krimet e supozuara të kryera gjatë luftës dhe pas saj deri në fund të vitit 2000. Për këtë folëm në kapitullin paraprak. Të shohim këtu më konkretisht si duket kjo bartje e juridiksionit të **Gjykatës Kushtetuese** në **Gjykatën Speciale**.

Në dokumentin e miratuar më datën 7 janar 2011[85], **AP** e **KE**-së theksonte krimet që ishin kryer në Kosovë gjatë luftës dhe menjëherë pas saj, duke kërkuar nga autoritetet kosovare dhe **EULEX**-i që të ndihmonin dhe bashkëpunonin në hetimin e pohimeve të senatorit zviceran dhe ish-prokurorit **Dik Martit**. Këto hetime duheshin kryer nga një prokuror i pavarur me qëllim të vërtetimit nëse pohimet e tij se në **Kosovë** ishin kryer krime lufte dhe krime kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare si dhe krime të tjera të rënda pas hyrjes së trupave të **NATO**-s në qershor të vitit 1999. Për këtë qëllim u urdhërua krijimi i një **Task - Forcë për Hetime Speciale** brenda misionit ekzistues të **EULEX**-it, por në tërësi e pavarur nga ky mision.[86] Detyrimet e **Kosovës** nga ky raport i **AP** të **KE** u pranuan me një vendim të përfaqësuesit të sovranit kosovar, **Kuvendit të Kosovës**, i cili ratifikoi marrëveshjen ndërkombëtare në mes të **Kosovës** dhe **BE**-së për vazhdimin e mandatit të misionit **EULEX** në **Kosovë**, në kuadër të të cilit gjendej edhe **Task-Forca**.[87] Në kuadër të këtij zotimi ndërkombëtar ka qenë edhe amendamentimi i

---

82 Cf. neni 28.3 ["Emërimi i gjyqtarëve"] i **Ligjit Nr. 05/L -053.** Fjala, pra, është për shefin e misionit **EULEX** në Kosovë si autoritet emërues.

83 Cf. neni 27 ["Kualifikimet e gjyqtarëve të Dhomave të specializuara"] i **Ligjit Nr. 05/L -053**

84 Neni 26.4 ["Regjistri i gjyqtarëve ndërkombëtarë"] i **Ligjit Nr. 05/L -053:**
"5. Regjistri i gjyqtarëve ndërkombëtarë përfshin tre gjyqtarë kushtetues që mund të caktohen për të shqyrtuar ndonjë referim për Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ('gjyqtarët e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese"), dhe një gjyqtar kushtetues rezervë."

85 Cf. "Inhuman treatment of people and illicit trafficking in human organs in Kosovo". Report|Doc. 12462| 07 January 2011. Në internet:http://assembly.coe.int/në/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=12608 &lang=en (shikuar në janar 2018).

86 Në fillim, kur u miratua rezoluta e **AP**, raporti i **Dick Martit** iu bashkëngjit si shtojcë. Në praktikë, kur nisi puna e hetimeve sipas raportit **Dick Marti**, nisën pengesat. Për këtë arsye, **SHBA**-të dhe **BE** nisën një ofensivë serioze për themelimin e **Gjykatës Speciale** dhe e futën lëtë si agjendë për integrim në BE të Kosovës dhe si një çështje ndërkombëtare. Cf. Fisnik Korenica, Argjend Zhubi, Dren Doli, ".The EU-engineered hybrid and international specialist court in Kosovo: Hoë 'special' is it?, fq. 476-478.

87 **Ligji nr. 04/L-274 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë**. Datë 23 prill 2014. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* nr. 32/14. Ky ligj përmban zotimin e Republikës së Kosovës për krijimin e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar në kuadër të sistemit gjyqësorë të Kosovës që do të përdoren për procedurat gjyqësore dhe të apelit që dalin nga hetimi i **Task-Forcës për Hetime Speciale të Republikës së Kosovës** në lidhje me dokumentin 12462 më të cilin **AP** të **KE** në datën 7 janar 2011 ka miratuar raportin **Dik Marty**. Këto dhoma, sipas këtij ligji, do të mund të ri-zhvendosen në një shtet të tretë.

Kushtetutës, me qëllim që të lejohet themelimi i një gjykate speciale me qëllim të trajtimit dhe gjykimit të kryesve eventual të veprave penale si më sipër, në të gjitha nivelet gjyqësorit të rregullt. Në këtë kuadër parashikohej edhe themelimi i një **Dhome të Specializuar Kushtetuese (Dhoma Kushtetuese)**.

Amendamenti kushtetues që ka shërbyer si bazë juridike për themelimin e Gjykatës njihet me emërin **amendamenti kushtetues nr. 24**, tani neni 162 i Kushtetutës, të cilin e zumë në gojën në kapitullin paraprak.[88] Ai është miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 05-V-139 të datës 3 gusht 2015. Sipas procedurës standarde, çdoherë kur bëhet fjalë për amendamentime kushtetuese, kryetari i Kuvendit dërgon draftinin e tyre në Gjykatë Kushtetuese për kontroll. Ky amendament nuk bën përjashtim: më datën 9 mars 2015, kryetari i Kuvendit ka dërguar amendamentin nr. 24 në Gjykatën Kushtetuese për të kaluar kontrollin kushtetues. Gjetja e saj ka qenë se themelimi i Gjykatës Speciale është në pajtim me Kushtetutën.[89]

Në literaturë, ka autorë që mendojnë në mënyrë të gabuar se baza kushtetuese për themelimin e **Gjykatës Speciale** nuk ka ekzistuar në Kushtetutën e vitit 2008, se **Gjykata Kushtetuese** në mënyrë të gabuar ka përdorur rastin **Fruni v. Slovakia** (2011) të GJEDNJ dhe, në fund, se neni 4.5 i Kushtetutës ndalon themelimin e çfarëdo gjykate tjetër në kuadër të sistemit kosovar të gjyqësisë, jashtë atyre që ekzistojnë sot dhe që janë përcaktuar me Kushtetutë dhe me **Ligjin për Gjykatat.**[90] Kjo është tërësisht gabim,[91] nisur nga fakti se dispozita e nenit 4.5 si më sipër vetëm definon pushtetin gjyqësor si unik, të pandarë, të pavarur dhe që ushtrohet nga gjykatat. Kjo dispozitë tingëllon si tautologji dhe e tillë është nëse shikohet në mënyrë të izoluar dhe jashtë kontekstit komparativ, siç kanë bërë autorët në fjalë. Kjo është kështu për shkak se, në secilën kushtetutë të vendeve demokratike në dy anët e **Atlantikut**, bëhet definimi i sistemit gjyqësor si sistem unik dhe i pandarë që ushtrohet nga gjykatat. Vetëm gjykata më e lartë në nivel nacional, ndërkaq, përmendet në kushtetutë nacionale me emër, kurse tjerat nivele rregullohen me ligje. Një qasje si kjo është krejt normale: vetëm me kushtetutë definohet fizionomia dhe funksioni primar i nivelit më të lartë gjyqësor në nivel nacional, duke ia lënë ligjit normimin llojit të gjykatave të tjera, organizimin dhe funksionimin e tyre. Përveç kësaj, në kushtetutë përcaktohet, në vendet që i takojnë demokracive kushtetuese, edhe cili lloj i gjykatave nuk lejohet (zakonisht gjykatat e jashtëzakonshme), përkatësisht se lejohet themelimi i gjykatave të specializuara. Kjo është kështu edhe në Kosovë: neni 103.7 ["Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave"] të Kushtetutës përcakton se mund të themelohet gjykata të specializuara por jo gjykata të jashtëzakonshme. Amendamenti nr. **24** nuk është asgjë tjetër vetëm operacionalizim dhe qartësim i kësaj dispozite kushtetuese.

Për këtë arsye, në vendimin e vet lidhur me kontrollin kushtetues të amendamentit nr. 24, **Gjykata Kushtetuese** ka përdorur rastin **Fruni v Sllovakia** si mbështetje juridike me qëllim të qartësimit se për çfarë juridiksioni të specializuar bëhet fjalë në rastin e Kosovës. Për këtë qëndrim janë marrë parasysh disa arsye. E para, se detyrimet ndërkombëtare të Kosovës mbizotërojnë ndaj çdo ligji të zakonshëm të Kosovës, përfshirë edhe **Ligjin për Gjykatat**. E dyta, se ky detyrim i Kosovës ka qenë dhe ngelet detyrim kundrejt zbatimit të **KEDNJ** ashtu siç interpretohet ajo nga **GJEDNJ,** një detyrim ky kushtetues nga neni 53 i Kushtetutës, më i lartë se çdo detyrim tjetër i secilit autoritet publik kosovar. E treta, rasti **Fruni v. Slovakia të cilin e ka marrë për bazë të vendimit të saj Gjykata Kushtetuese**, pikërisht shëmbëllen dhe pasqyron fizionominë e një gjykate speciale që mund të themelohet me qëllim të adresimit të krimeve speciale dhe të veçanta, siç janë ato të luftimit kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit (që ka qenë objekt i rastit në fjalë). Nga kjo del qartë se autorët e kanë të paqartë argumentimin e **Gjykatës Kushtetuese**, caqet e të cilit nuk kufizohen vetëm në kapitullin e dytë të Kushtetutës, por edhe në kapitullin e tretë, germën dhe frymën e saj.

---

88 Seksioni 10.4 i kapitullit 10 të këtij libri.

89 *Rasti K0 26/15. Aktgjykim. Vlerësim i amendamentit të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe referuar me 9 mars 2015 nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, me Shkresën nr. 05-433jDO-318.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.: AGJ 788/15. Prishtine, me 15prill 2015.

90 Ligji nr. 03/L-199 për Gjykatat i datës 24 gusht 2010 (me ndryshimet dhe polotësimet e mëvonshme deri në vitin 2015). *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* nr. 79/2010.

91 Fisnik Korenica, Argjend Zhubi, Dren Doli, "The EU-engineered hybrid and international specialist court in Kosovo: How 'special' is it? fq. 480-481.

Në këtë të fundit, në frymën e Kushtetutës, hyjnë dispozitat kushtetuese mbi pushtetin gjyqësor unik, të pandarë dhe të pavarur në Kosovë si dhe ato që lejojnë themelimin e gjykatave të specializuara. Pa dyshim që themelimi i Gjykatës Speciale bie në këto dispozita lejuese, në ndërkohë që zbërthimi dhe qartësimi i fizionomisë së saj është kryer me amendamentin nr. **24 të Kushtetutës.**[92] I vetmi rast që sot për sot në Kosovë me të vërtetë ka shkaktuar prishjen dhe paralelizmin potencial në sistemin gjyqësor unik, në mënyrë antikushtetuese, pra ka prishur pushtetin gjyqësor unik dhe të pandarë e të pavarur nga neni 4.5 i Kushtetutës, ashtu siç e ka interpretuar Gjykata me Aktgjykimin në rastin **KO 26/15**, ka të bëjë me themelimin efektiv të një gjykate të re të apelit në veri të **Kosovës**. Ky fakt, megjithatë, asnjëherë nuk është sfiduar në **Gjykatën Kushtetuese** ashtu që vlen prezumimi i kushtetutshmërisë së saj dhe akteve juridike me të cilat është themeluar.

Amendamenti nr. **24** ka gjithsej katërmbëdhjetë paragrafë. Në paragrafin e parë përcaktohet, **inter alia**, se:
" [...] organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i **Dhomave të Specializuara** dhe **i Zyrës së Prokurorit të Specializua**r rregullohen me këtë nen dhe me ligj të veçantë".
Fizionomia e **Dhomës Kushtetuese**, ndërkaq, rregullohet me paragrafin e tretë të amendamentit. Në këtë paragraf dalin në syprinë dy aspekte: së pari, aty thuhet se Dhoma do të përbëhet nga tre gjyqtarë ndërkombëtarë, të cilët do të jenë të ndryshëm nga ata që janë emëruar sipas nenit 114.1 ["Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese"] i Kushtetutës;[93] dhe, së dyti, ajo dhomë do të vendosë ekskluzivisht mbi referimet kushtetuese sipas nenit 113 të Kushtetutës në lidhje me **Dhomat e Specializuara** dhe me **Zyrën e Prokurorit të Specializuar** në përputhje me ligjin e veçantë. Me ligj të veçantë nënkuptohet **Ligji nr. 05/L -053.**[94] Kur flitet për referimet nga neni 113 i Kushtetutës, ndërkaq, mendohet për palët e autorizuara sipas atij neni. Teorikisht, si të tilla mund të paraqiten të gjitha që janë të numëruara aty në atë nen. Në praktikë, megjithatë, ekziston vetëm një palë e autorizuar të cilën **amendamenti nr. 24** shpreh interes për ta normuar.
Në mënyrë shprehimore, amendamenti përmend vetëm një palë të autorizuar. Në fjalinë e fundit në paragrafin njëmbëdhjetë tëtij thuhet se "**Ombudsperoni i Kosovës** mund të referojë çështje në përputhje me nenin 135 (4)".[95] Se për cilin ombudsperson është fjala, këtë që zgjidhet nga Kuvendi i Kosovës sipas nenit 134.1 ["Kualifikimi, Zgjedhja dhe Shkarkimi i Avokatit të Popullit"] të Kushtetutës apo për atë tjetrin ombudsperson që themelohet sipas nenit 34. 9 ["Zyra Administrative"] të **Ligjit nr. 05/L -053** si më sipër? Këtë dilemë e largon vetë ligji në fjalë që përcakton deri në detaje, përveç në nenin 34.9 si më sipër edhe në nenin 49 pikat 1, 2 dhe 5 ["Peticioni në Gjykatën Kushtetuese"][96], se kush mund të jenë palë të autorizuara në procedurën pranë saj. Të shohim si duken formulimet e këtyre dy neneve.
Neni 34.9 i **Ligjit nr. 05/L -053** përcakton.

[…] "9. Zyra Administrative përmban brenda vetes **Zyrën e Ombudspersonit**, e cila e kryen detyrën e **Ombudspersonit e Dhomave të Specializuara** me përgjegjësi ekskluzive për **Dhomat e Specializuara** dhe **Zyrën e Prokurorit të Specializuar** sipas Amendamentit nr 24 të Kushtetutës. Ligji për

[92] Paragrafi 49 i Aktgjykimit në rastin KO **26/15**: "Rrjedhimisht, duke marrë parasysh që amendamenti i propozuar ka për qëllim të themelojë me ligj dhomat e specializuara, ai është në përputhje me atë kërkesë të nenit 103, paragrafi 7, të Kushtetutës". Cf. edhe paragrafët nr. 22, 37-68 të këtij aktgjykimi, të cilat natyrshëm dhe në mënyrë të veçantë argumentojnë këtë që konstatohet në paragrafin nr. 49 si më sipër.

[93] Këtu bëhet fjalë për tre gjyqtarët ndërkombëtarë që kanë punuar si gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese në Kosovë nga vitit 2009 deri në vitin 2018. Për këtë diskutojmë në seksionet 12.1 dhe 12.2 të kapitullit dymbëdhjetë.

[94] Cf. fusnota nr. **78**, **supra**, në këtë seksion.

[95] Fjala është për nenin 135. 4["Raportimi i Avokatit të Popullit"] të Kushtetutës, që thot. […] 4. Avokati i Popullit ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute."

[96] Sikundër shihet këtu përdoret termi "Gjykatë Kushtetuese". Ky emërtim shfaqet edhe në versionin anglisht të **Ligjit nr. 05/L -053**. Kjo bëhet për të treguar se çdo çështje kushtetuese që ka të bëjë me **Gjykatën Speciale**, edhe nëse rastësisht në mënyrë të gabuar paraqitet në Kosovë, në **Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës**, kompetent do të jetë **Dhoma e Specializuar Kushtetuese**. Kjo nënkupton se në Kosovë efektivisht ka dy gjykata kushtetuese, sikundër që ka edhe dy gjykata penale të të gjitha shkallëve dhe një prokurorë shtetëror për të gjitha nivelet penale që kanë të bëjnë me juridiksionin e Gjykatës Speciale.

Ombudspersonin, Ligji nr. 03/L-195, nuk zbatohet për punën e **Dhomave të Specializuara** dhe **Zyrën e Prokurorit të Specializuar**. Ombudspersoni do të emërohet nga **Autoriteti Emërues** pas shqyrtimit të aplikantëve të kualifikuar. Ombudspersoni ka karakter të lartë moral dhe është kompetent në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut. Roli dhe funksioni i **Ombudspersonit të Dhomave të Specializuara** rregullohet në Rregullat e Procedurës dhe Provave. **Ombudspersoni i Dhomave të Specializuara** mund t'i jap rekomandime Kryetarit të **Dhomave të Specializuara** ose **Zyrës së Prokurorit të Specializuar** sipas nenit 135(3) të Kushtetutës dhe mund të bëjë referime për tek Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenet 113(2) dhe 135(4) të Kushtetutës dhe nenin 49 të këtij ligji".

Neni 49 pikat 1, 2 dhe 5 **Ligjit nr. 05/L -053** thotë:

"[…] **1. Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese** është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës në lidhje me juridiksionin lëndor dhe punën e **Dhomave të Specializuara** dhe **Zyrës së Prokurorit të Specializuar**.

2. Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese ka juridiksion mbi çdo referim tek Gjykata Kushtetuese të bërë nga personat e autorizuar për të bërë referime në bazë të nenit 113 të Kushtetutës që ndërlidhen me, apo që kanë ndikim të drejtpërdrejtë mbi, punën, vendimet, urdhrat apo aktgjykimet e **Dhomave të Specializuara** apo me punën e **Zyrës së Prokurorit të Specializuar.**
…
5. Në pajtim me **Amendamentin nr. 24** dhe nenin 135(4) të Kushtetutës, **Ombudspersoni i Dhomave të Specializuara** i caktuar sipas nenit 34(9) të këtij ligji, si dhe Ombudspersoni i Republikës së Kosovës, mund t'i referohen sipas nenit 113(2) **Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese** […]."

Nga kjo dispozita shumë qartë shihet se fjala është për një ombudsperson paralel me seli në **Hagë**, që është themeluar sipas **amendamentit kushtetues nr. 24. Ligji nr. 05/L -053,** nuk bën asgjë veçse, përmes dy neneve të sipër cekura, operacionalizon rolin dhe funksionin e këtij institucioni paralel në kuadër të sistemit kushtetues kosovar. Kjo më tutje nënkupton se këtu nuk është fjala për **Avokatin e Popullit që ka selinë në Prishtinë** dhe që funksion sipas autorizimeve nga nenet 132-135 të Kushtetutës së vitit 2008. Kjo është kështu për faktin se **amendamenti kushtetues nr. 24** rezervon një rol të privilegjuar dhe një fizionomi tjetërfare për **Ombudspersonin e Dhomave të Specializuara**. Avokatit të Popullit me seli në Prishtinë nuk ia prekë të drejtë për t'u paraqitur si palë në procedurë pranë **Gjykatës Speciale për çështjet nga neni 113.2 ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] të Kushtetutës, gjithnjë me kusht që fjala është për çështjet që kanë të bëjnë me juridiksionin lëndor dhe punën e Gjykatës Speciale.** Me këtë qasje të **amendamentit kushtetues nr. 24** dhe të **Ligji nr. 05/L -053**, Ombudspersoni i Dhomave të Specializuara fiton një pozitë të privilegjuar kundrejt Avokatit të Popullit me seli në Prishtinë, sepse mban monopolin e palës së autorizuar për çdo referim kushtetues që ka të bëjë me juridiksionin lëndor dhe punën e **Gjykatës Speciale** e që mund të subsumohet (nënvihet) nën nenin 113.2 ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] lidhur me nenin 135.4 ["Raportimi i Avokatit të Popullit"] të Kushtetutës.

Thënë me fjalë tjera, Ombudspersoni i Kosovës me seli në Hagë mund të ngre pranë Gjykatës Kushtetuese në me seli në Hagë rastet në vijim:

- çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën; dhe
- çështjen e përputhshmërisë së statutit të komunës me Kushtetutën e vitit 2008.

Afatet për ushtrimin e këtij autorizimi janë të njëjta sepse për këtë vlen në tërësi **Ligji nr. 03/L-121.** Ky ligj vlenë vetëm sa i përket procedurave nga paragrafi i parë i nenit 113.2 të Kushtetutës së vitit 2008, meqenëse vështirë se mund të krijohet ndonjë situatë në të cilën një statut i një komune kosovare do të kishte për objekt normimin e çështjeve që bien në kompetencën lëndore dhe apo që lidhen me punën e **Gjykatës Speciale**. Janë nenet 29 dhe 30 të **Ligjit nr. 03/L-121** me të cilat rregullohen procedurat e veçanta lidhur me nenit 113.2 të Kushtetutës, sqarohen veprimet, procedurat dhe efektet e tyre. Sipas

këtyre neneve, kërkesa për kushtetutshmërinë e ligjeve, dekreteve të Presidentit dhe të Kryeministrit, si dhe të rregulloreve të Qeverisë mund të paraqitet brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtyre akteve juridike. Kontestimi i kushtetutshmërisë së tyre mund të jetë i tërësishëm apo i pjesshëm, ndërsa efektet e vendimeve të **Dhomës Kushtetuese** është i njëjtë me efektet e vendimeve të **Gjykatës Kushtetuese.**

Sikundër u tha me sipër dhe siç shihet nga dispozitat që sapo u komentuan, palët tjera të autorizuara nga neni 113 i Kushtetutës ngelin të njejta. Kjo do të thotë se ajo që thuhet në vijim të seksioneve të këtij kapitulli lidhur me juridiksionin aktual të **Gjykatës Kushtetuese**, ka vlefshmëri, **mutatis mutandis**, edhe për palët tjera të autorizuara dhe procedurat që mund të iniciohen nga to sipas nenin 113 të Kushtetutës, gjithnjë me supozimin se fjala është për çështje që bien në kompetencën lëndore apo kanë të bëjnë me punën e **Gjykatës Speciale.**[97]

11.3. Juridiksioni aktual i Gjykatës Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese ka juridiksionin më të gjerë të mundshëm, krahasuar me gjykatat simotra në **Ballkan.** Ai është shumë i afërt me sistemin gjerman të gjyqësisë kushtetuese. Kjo do të thotë, me një fjalë, se ajo ka juridiksion mbi të gjitha veprimet e të gjitha autoriteteve publike në vend, përfshirë këtu gjyqësorin. Shumë pak çështje kanë ngelur jashtë juridiksionit të saj. Të tilla janë, ta zëmë, procedurat sipas **actio popularis**, mekanizmi i kontrollit kushtetues të partive politike, procedurat penale kundër funksionarëve të lartë shtetëror etj.

Lloji i juridiksionit dhe kompetencat e gjykatave kushtetuese janë çështje e dizajnit kushtetues të një vendi, i nevojave të tij dhe qëllimeve që synohen. Në përgjithësi, dizajni kushtetues nacional reflekton nevojat dhe qëllimet që një shoqëri synon t'i arrijë në një kohë dhe hapësirë të caktuar. Për këtë arsye, ato nevoja dhe synimet që qëllimoren, jo domosdo, reflektojnë ndjenjat reale të popullsisë dhe stofin e tyre kulturor. Juridiksioni i gjykatave kushtetuese, si pjesë e dizajnit kushtetues nacional, ndjek këtë fat. Ai çdoherë është në funksion të realizimit të vlerave dhe parimeve të mishëruara në dizajnin kushtetues nacional me qëllim të përafrimit të tij sa më shumë me atë që është shkruar dhe thënë në tekstin origjinal kushtetues, ani se në praktikë devijimi nga ai tekst mund të jetë i madh.

Juridiksioni kushtetues i përcaktuar në kuadër të dizajnit kushtetues nacional, nuk ka asnjë dyshim, paraqet pjesë përbërëse dhe definuese të fizionomisë së gjyqësisë kushtetuese përkatëse. Kjo zakonisht shihet nga dispozita kushtetuese me të cilën përcaktohet lloji i organit apo organeve që ushtrojnë funksionin e gjyqësisë kushtetuese në vend. Kosova nuk përbën përjashtim në këtë aspekt. Ndër ne, kjo fizionomi përcaktohet me paragrafin e parë të nenin 112 ["Parimet e Përgjithshme"] të Kushtetutës, me të cilin nis kapitulli i VIII ["Gjykata Kushtetuese"]. Shih për këtë, ka shumë rëndësi që, para se të kalojmë në llojet e juridiksionit konkret kushtetues nga neni 113 i Kushtetutës, sërish të themi disa fjalë për **fizionominë e gjyqësisë kushtetuese kosovare**. Ajo fizionomi, sikundër u tha disa herë më sipër, përcaktohet në nenin 112.1 lidhur me nenin 4.6 të Kushtetutës. Ai specifikohet si strukturë konkrete në tërësi me nenin e saj 113.

---

[97] Për shqyrtimet teorike të juridiksionit, organizimit dhe punës së **Gjykatës Speciale**, jashtë aspekteve që kanë të bëjnë me gjyqësinë kushtetuese, cf. më shumë në. Emanuele Cimiotta, The Specialist Chambers and the Specialist Prosecutor's Office in Kosovo. The'Regionalization'of International Criminal Justice in Context". *Journal of International Criminal Justice* Vol. 14 Issue 1 (March, 2016) fq. 1 - 20; Sarah Williams, "The Specialist Chambers of Kosovo. The Limits of Internationalization?" *Journal of International Criminal Justice* Vol. 14 Issue 1 (March, 2016) fq. 25-51; Mattheë E. Cross, " Equipping the Specialist Chambers of Kosovo to Try Transnational Crimes: Remarks on Independence and Cooperation" *Journal of International Criminal Justice* Vol. 14 Issue 1 (March, 2016) fq. 73-100; Lachezar Yanev, "Co-Perpetration Responsibility in the Kosovo Specialist Chambers Staying on the Beaten Path?". *Journal of International Criminal Justice* Vol. 14 Issue 1 (March, 2016) fq. 101-121; Gabriella Citroni, "The Specialist Chambers of Kosovo: The Applicable Law and the Special Challenges Related to the Crime of Enforced Disappearance" *Journal of International Criminal Justice* Vol. 14 Issue 1 (March, 2016) fq. 123-143; Fisnik Korenica, Argjend Zhubi & Dren Doli, "The EU-engineered hybrid and international specialist court in Kosovo: How 'special' is it? fq. 474–498.

Paragrafi i parë i nenit 112 përcakton natyrën e përgjithshme të autoritetit të Gjykatës Kushtetuese, duke i vënë themelet e saj të karakterit **evropian/kelzenian** përmes stipullimit që përcakton se Gjykata "është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e kushtetutës dhe kontrollin e përputhshmërisë së ligjeve me kushtetutën". Ky definim, siç e kemi cekur më herët në këtë kapitull, duhet shikuar në lidhje me nenin 4.6 të Kushtetutës, që definon Gjykatë si një trup që "është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës" **Vetëm së bashku, këto dy nene japin fizionominë e plotë që ka Gjykata: si një organ shtetëror që bën kontrollin kushtetues të normave të përgjithshme dhe të akteve juridike konkrete të organeve shtetërore me qëllim të mbrojtjes së kushtetutshmërisë në Kosovë, përkatësisht me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës së vitit 2008**. Kjo nënkupton se interpretimi i Kushtetutës bëhet kryesisht në procedurat ku për objekt kontrolli çdoherë paraqitet një akt i përgjithshëm ose një akt apo veprim konkret individual i një organi shtetëror. Interpretimi kushtetues nuk ekziston në gjyqësinë kushtetuese kosovare pa pasur para vetës një akt juridik apo veprim si më sipër. Kjo shihet qartë nga lista e kompetencave që janë përcaktuar brenda juridiksionit të nenit 113 të Kushtetutës.

Në praktikë, megjithatë, ky nuk ka qenë rasti çdoherë: në **rastin e imunitetit** të deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe në disa raste të tjera, Gjykata ka vendosur për të kryer interpretimin e Kushtetutës pa pasur para vetës një akt të përgjithshëm (ligj, amendament etj), një akt individual juridik (dekret, vendim gjyqësor etj.) apo një veprim (shkelje konkrete e Kushtetutës në kuptim të nenit 113.6 të Kushtetutës).[98] Në **Kosovë**, thënë ndryshe, sipas nenit 113 të Kushtetutës mund të ushtrohet vetëm kontrolli kushtetues i normave të përgjithshme, që përbën interpretim klasik kushtetues të tipit kelsenian, si dhe kontrolli kushtetues i akteve dhe veprimeve individuale të organeve shtetërore. Nuk mund të këtë interpretim **të thatë** apo **në vakum** të Kushtetutës, pa pasur një akt apo veprim para vetës me qëllim që, përmes kontrollit të kushtetutshmërisë së tij, të vihet deri të saktësimi i kuptimit të normës përkatëse kushtetuese.

Për dallim nga Kushtetuta e **SHBA**-ve, e cila nuk përcakton se cili është institucioni që bën interpretimin përfundimtar të kushtetutës,[99] ky paragraf si më sipër i Kushtetutës bën përcaktimin shprehimor të institucionit që bën interpretimin përfundimtar të kushtetutës dhe kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve. Aty, në paragrafin e parë të nenit 112 të Kushtetutës, sikundër shihet, nuk flitet për aktet apo veprimet tjera juridike, por vetëm për ligjet. Kjo duhet të interpretohet si diçka që nënkuptohet për nga vetë natyra e punës së gjykatave kushtetuese: ato janë interpretues të kushtetutës dhe këtë aktivitet shtetëror e ushtrojnë përmes teknikave të ndryshme, ku kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjeve përbën mekanizimin më të vjetër dhe më parësor. Ky mekanizëm, në fakt, i bën këto gjykata të dallueshme nga gjyqësori i rregullt dhe nga çdo aktivitet tjetër shtetëror, duke i cilësuar si model **evropiano/kelsenian** i gjyqësisë kushtetuese.

Përcaktim i këtij paragrafi vendos tri parimet themelore të gjyqësisë kushtetuese kosovare, që janë të njëjta me familjen së cilës i takon: e para, që ushtrimi i funksionit të kontrollit kushtetues bëhet nga ana e një organi të centralizuar, i cili bart monopolin e kontrollit të kushtetutshmërisë (**Normververfungsmonopol**);[100] e dyta, që gjykata kushtetuese është e veshur me autoritetin e kontrollit abstrakt të normës juridike, në kuptim të kushtetutshmërisë së saj; dhe, *e treta*, që efekti i vendimeve të kësaj gjykate, në kuptim të fuqisë së tyre juridike, është përfundimtar dhe nuk mund t'i nënshtrohen rishikimit nga cilido institucion/mekanizëm shtetëror. Përmes përcaktimit që gjykata kushtetuese është interpretuesi përfundimtar i kushtetutës, ky paragraf vendos mekanizmin që duhet të kujdeset për pozitën hierarkike

---

98 Kjo praktikë e Gjykatës ka nisur me rastin **Qeska**. Cf. fusnotat 47 dhe 51, **supra**, në këtë seksion, si dhe tekstin që i shoqëron. Si e tillë, ka vazhduar deri në vitin 2018 kur është vendosur rasti **KO 79/18**, kur më një vendim të natyrës jo meritore u vendos se kjo praktikë duhej ndërprerë. Cf. fusnotat 114 & 115, në **kapitulllin 16**-të, si dhe teksti që i shoqëron aty.

99 John N. Hostettler and Thomas W. Washburne, "The Constitution's Final Interpreter: We the People." *Regent University Law Review.* Vol. 8 (Spring, 1997) fq. 13-32.

100 Christoph Grabenwarter, "Separation of Powers and the Independence of Constitutional Courts and Equivalent Bodies". *Keynote Speech, 16 January 2011, 2nd Congress of the World Conference on Constitutional Justice* (Rio de Janeiro, 2011).

të kushtetutës përballë akteve të tjera juridike të përgjithshme, duke emëruar institucionin përgjegjës për këtë detyrë. Sipas tij, Gjykata është **vetëm** kontrollor i kushtetutshmërisë dhe jo ligjshmërisë, siç janë disa gjykata kushtetuese në **Evropën Juglindore**.

I rëndësisë së veçantë për këtë paragraf është koncepti që Gjykata Kushtetuese është **autoriteti përfundimtar për interpretimin e kushtetutës**. Tri janë gjërat që duhet zbërthyer.

- e para, çfarë kuptimi juridik ka përcaktimi që ajo është autoriteti përfundimtar në kryerjen e këtij funksioni?
- e dyta, çfarë natyre juridike ka koncepti **interpretim** i vënë në këtë paragraf? dhe
- e treta, çfarë strukture ka funksioni i interpretimit që ushtron Gjykata sipas këtij paragrafi?

Sa i përket çështjes së parë, koncepti që **Gjykata Kushtetuese** është autoriteti përfundimtar i interpretimit të kushtetutës është i lidhur me pozitën hierarkike institucionale që këtij institucioni i jep ky paragraf. Në këtë kuptim, ai e vendos atë në pikën më të lartë të hierarkisë institucionale sa i përket funksionit të interpretimit të kushtetutës. Kjo, në kuptimin institucional, ka katër domethënie:

- që, asnjë institucion tjetër shtetëror nuk mund t'i marrë apo të ushtrojë në emër të Gjykatës Kushtetuese funksionin e interpretimit përfundimtar kushtetues;
- që, edhe nëse cilido institucion tjetër shtetëror ka bërë interpretimin apo është referuar tek Kushtetuta për të ushtruar një kompetencë të tij, kjo mund të konsiderohet përfundimisht e përcaktuar vetëm nëse kalon përmes filtrit të vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese;
- që, asnjë institucion tjetër shtetëror nuk mund të shfrytëzojë prerogativat e tij faktike për të vendosur nënkuptime të domethënies së Kushtetutës, dhe se prerogativat e tilla mund të konsiderohen kushtetuese vetëm nëse kalojnë përmes vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese; dhe
- që, asnjë institucion tjetër shtetëror nuk mund t'i ikë detyrimit (të bishtnojë) që të ndjekë interpretimin e Kushtetutës ashtu siç ka përcaktuar Gjykata Kushtetuese, meqë kjo e fundit, sipas këtij paragrafi, është autoriteti i fundit institucional për interpretimin e saj.

Sa i përket çështjes së dytë, koncepti interpretim i kushtetutës është i rëndësisë së veçantë për të përcaktuar natyrën juridike të vendimeve dhe autoritetin e Gjykatës. Në kuptim të këtij paragrafi, ajo vishet me kompetencën e **vendosjes së domethënies së normave të Kushtetutës** (**saktësimit të tyre**). **Kjo nënkupton se Gjykata nuk krijon norma, vetëm vendos domethënien e normave ekzistuese të Kushtetutës, i saktëson ato**. Relevanca e këtij paragrafi sa i përket kësaj çështjeje ka tri domethënie juridike:

- që, interpretimi i kushtetutës nënkupton vendosjen në lidhje me nënkuptimin e normave të saj abstrakte, dhe aplikimin e tyre në rastet e caktuara abstrakte, por edhe në rastet individuale/konkrete. Vendosja e domethënies së normave kushtetuese, në anën tjetër, lë të kuptohet që normat kushtetuese duhet të lexohen dhe zbatohen ashtu siç interpretohen nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, sipas këtij paragrafi, Kushtetuta nuk mund të interpretohet sipas versionit të lirë të cilitdo institucion, por ka një mekanizëm të specializuar dhe me kompetencë ekskluzive të interpretimit të saj përfundimtar;
- që, vendimet e Gjykatës Kushtetuese për interpretimin e kushtetutës, sipas konceptit për interpretim të këtij paragrafi, shndërrohet në substancë të vet kushtetutës, meqë, normat kushtetuese kanë atë kuptim që Gjykata Kushtetuese i vendos sipas vendimeve të saj;
- që, koncepti interpretim, i vënë në këtë paragraf, nuk nënkupton një funksion fakultativ apo konsultativ sa i përket domethënies së normave kushtetuese. Në kuptim të këtij paragrafi, koncepti **interpretim** shfrytëzohet për të nënkuptuar një vendim detyrues sipas së cilit të gjitha institucionet e shtetit duhet të sillen, dhe që kjo nuk lejon asnjë hapësirë për cilindo institucion që të thirret në të drejtën vetjake të interpretimit të kushtetutës.

Në vijim si më sipër, Gjykata nuk është interpretuesi ekskluziv i kushtetutës. Interpretimi i saj ndodh në çdo sekondë të jetës institucionale për aq kohë sa institucionet i shkarkojnë detyrimet e tyre të cilat juridik-

isht rrjedhin nga Kushtetuta. Ekskluziviteti i Gjykatës për interpretim ka domethënie tjetër: ajo ka autoritet ekskluziv institucional sa i përket filtrit të fundit të interpretimit të Kushtetutës. Kjo nënkupton se, kur rasti shkon për interpretim në Gjykatë, vendimi i saj bëhet përfundimtar në kuptimin institucional dhe juridik. Koncepti i interpretimit ekskluziv përfundimtar, me fjalë tjera, nuk duhet ngatërruar me interpretimin ditor që i bëhet Kushtetutës nga ana e mekanizmave të cilëve iu buron kompetenca nga kjo e fundit.

Një çështje shumë e rëndësishme në kuptim të këtij paragrafi është nëse ekziston ndonjë mekanizëm institucional përmes të cilit vendimet mbi interpretimin përfundimtar të kushtetutës mund të rrëzohen? Në kuptim të sistemit të gjyqësisë kushtetuese amerikane, vendimet interpretuese të **Gjykatës Supreme** mund të rrëzohen vetëm përmes amandamentimit të kushtetutës dhe ndryshimit eksplicit të dispozitës mbi të cilën mbështetet interpretimi i gjykatës në fjalë. Një gjë e tillë ka ndodhur shumë herë në **SHBA**, pra kur vendimet përfundimtare të **Gjykatës Supreme** mbi interpretimin e kushtetutës janë rrëzuar përmes amendamenteve kushtetuese.[101] Pyetja e njëjtë shtrohet te ne sa i përket vendimeve të nxjerra nga ana e Gjykatës në vijim të ushtrimit të juridiksionit të saj të definuar me nenin 113 të Kushtetutës. Të shohim si duket kjo në rastin e Kosovës.

Kushtetuta në nenin 144, paragrafët 3 dhe 4, përcakton që ndryshimet kushtetuese mund të miratohen nga Kuvendi vetëm pasi kryetari i **Kuvendit të Kosovës** të ketë dërguar amendamentin e propozuar në Gjykatën Kushtetuese për të vlerësuar paraprakisht nëse ndryshimi i propozuar pakëson ndonjë të drejtë dhe liri të përcaktuar në Kapitullin II të Kushtetutës. Neni 144, paragrafët 3 dhe 4, prandaj, bën që Kushtetuta të mos mund të ndryshohet nëse liritë dhe të drejtat e garantuara aty pakësohen. I shikuar në ndërlidhshmëri me nenin 144, paragrafët 3 dhe 4, neni 113 nënkupton që vendimet e Gjykatës sa i përket interpretimit të cilësdo normë të kapitullit II të Kushtetutës **nuk mund të rrëzohen me anën e amendamentit kushtetues**, nëse ky i fundit pakëson të drejtat dhe liritë e njeriut të kapitullit në fjalë. Ky përcaktim është eksplicit. Megjithatë, pyetja shtrohet a mund që amendamentet kushtetuese të rrëzojnë vendimet e Gjykatës jashtë situatave nga kapitulli II i Kushtetutës? Kushtetuta nuk jep përgjigje eksplicite sa i përket kësaj çështjeje. Mendimi i përgjithshëm është që amendamentet kushtetuese mund të rrëzojnë vendimet e saj nëse ato nuk janë të ndërlidhura apo nuk interferojnë në liritë dhe të drejtat e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës. Kjo, megjithatë, nuk është e tëra.

Në jurisprudencën e Gjykatës, megjithatë, në mënyrë të qartë është theksuar se kapitulli II nuk duhet të shikohet i izoluar nga kapitulli III ["Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre"] dhe nga kapitulli I ["Dispozitat Themelore"] i Kushtetutës, në veçanti kur është fjala për sundimin e ligjit dhe barazinë para ligjit, si dhe vlerat e parimet tjera kushtetuese. Ky qëndrim është rikonfirmuar disa herë në jurisprudencë.[102] Si i tillë, ky paraqet versionin kosovar të thënë përmes interpretuesit të fundit të Kushtetutës, Gjykatës Kushtetuese, të asaj që doktrina **gjermane** e ka cilësuar si "unitet strukturor i kushtetutës, letrës dhe frymës së saj".[103] Nga kjo del se amendamentet kushtetuese mund të rrëzojnë aktgjykimet e Gjykatës

---

[101] James McClellan, *Liberty, Order, and Justice: An Introduction to the Constitutional Principles of American Government*. 3rd ed.. (Liberty Fund: Indianapolis, 1989), në veçanti pjesa e shtatë (7) ("Changing the Constitution - Together with an Explanation of the Amendments Added Since 1791).

[102] Kështu janë, **inter alia**, dy aktgjykimet më emblematike që citojnë rastet nga e kaluara kur Gjykata ka konfirmuar këtë qasje të saj, përkatësisht. *Rastet KO 45/12 dhe KO 46/12. Aktgjykim. Kërkesa e Liburn Aliut dhe 11 deputetëve të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe dhe të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr.Ref.:AGJ 255/12 Prishtinë, më 25 qershor 2012. Paragrafët 61, 66; dhe *Rasti KO 130/15. Aktgjykim. Parashtrues: Presidentja e Republikës së Kosovës. Lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar "Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore" me frymën e Kushtetutës, me neni 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.:AGJ877/15. Prishtinë, 23 dhjetor 2015. Paragrafët. 108. 115, 119, 189, pikat 4 &5, si dhe pikat II & III të pjesës operative të Aktgjykimit.

[103] Për komentet shtesë, cf. Donald P. Kommers, "German Constitutionalism: A Prolegomenon". *Emory Law Journal.* Vol. 40 No. 1 (1991) fq. 837-873; Donald P. Kommers, *The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany.* Second Edition. (Duke University Press: Durham and London, 1997) fq. 3-60;.

vetëm nëse si të tilla nuk cenojnë dispozitat, parimet dhe vlerat kushtetuese të përmbajtura në Kapitujt I, II, dhe III të Kushtetutës, përkatësisht letrën, frymën dhe shpirtin e saj. Këto interpretime të Gjykatës formojnë doktrinë kosovare mbi atë se çka nuk mund të amendamentohet, përkatësisht **doktrinën kosovare mbi amendamentet jokushtetuese. Sipas kësaj doktrine ekzistojnë disa dispozita kushtetuese që nuk mund të amendamentohen asnjëherë për arsye se paraqesin thelbin e identitetit kushtetues të një vendi ashtu që ndryshim i tyre prek identitetin kushtetues.** Në disa kushtetuta në mënyrë shprehimore përcaktohet se cilat dispozita kushtetuese nuk mund të jenë objekt i amendamentimit. **Kosova** nuk ka këtë qasje: në Kushtetutë nuk përcaktohet se cilat pjesë të saj nuk mund të jenë objekt i amendamentimit, pra që nuk mund të ndryshohen në asnjë rrethanë. Nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, megjithatë, në mënyrë graduale dhe të qartë ravijëzohet dhe kristalizohet **doktrina kosovare mbi amendamentet jo kushtetuese**, përkatësisht doktrina që tregon se çka nuk mund të amendamentohet për shkak se e rrënon atë që përbën thelbin e **identitetit kushtetues kosovar**.

Çështje shumë e rëndësishme në këtë kuptim, por në ndërlidhshmëri edhe me nenin 113, është pyetja nëse Gjykata Kushtetuese përbën një organ brenda oborrit të pushtetit gjyqësor? Tri janë çështjet që duhen shikuar për të nxjerrë një përgjigje në këtë aspekt:

- nëse Gjykata është gjykatë e shkallës së katërt, e cila vepron si instancë e mjetit juridik të ankesës ndaj një gjykate të rregullt?;
- nëse Gjykata ushtron funksion 'gjyqësor'?; dhe
- nëse Gjykata ka ndonjë ndërlidhshmëri strukturore me ndonjërin nga tri pushtetet shtetërore (ekzekutivin, legjislativin dhe gjyqësorin)?

Përgjigja në këtë pyetje është relativisht e thjeshtë. Në rend të parë, shikuar në kuptim të juridiksional, **Gjykata Kushtetuese** nuk përbën gjykatë të instancës së katërt dhe as gjykatë të rregullt: ajo kryen një funksion subsidiar, atë të kontrollit (kryesisht abstrakt, por edhe konkret) kushtetues dhe në asnjë rast nuk është e lidhur strukturalisht me pushtetin gjyqësor apo me ndonjë pushtet tjetër. Si e tillë, ajo përbën një mekanizëm për kontroll kushtetues, e cila vendos thjeshtë dhe vetëm mbi çështje të natyrës kushtetuese, duke ia lënë organeve të tjera të pushtetit sendërtimin e tyre individual. **E themi kështu sepse kushtetutshmëria e akteve juridike dhe e veprimeve të organeve shtetërore supozohet përderisa ato nuk sfidohen në Gjykatën Kushtetuese, e cila ka fjalën e fundit lidhur me çdo çështje që ka të bëjë me domethënien e saktë të dispozitave kushtetuese**. Shikuar nga ky kënd, jo vetëm që nuk është gjykatë e rregullt, por ajo as nuk është pjesë e asnjërit nga tre pushtetet shtetërore, përfshirë atë gjyqësor, duke pasur një pozicion mbi të tre pushtetet. Kjo është kështu sepse, si gardian i Kushtetutës, ajo e ushtron rolin e vet të kontrollit të kushtetutshmërisë përmes kontrollit të akteve juridike dhe të veprimeve të tjera të të tri pushteteve, kurse ka pozicion institucional mbi të tri këto për aq kohë sa është në pyetje funksioni i saj primar – sigurimi i supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës.[104] Ajo çka kanë të përbashkët Gjykata Kushtetuese dhe tri pushtetet tjera është se të gjitha së bashku janë pjesë e asaj që quhet pushtet i konstituar (**pouvoir *constitué***), të cilat funksionojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, asgjë tjetër: në hierarki institucionale, Gjykata Kushtetuese rri e para. Sikundër dihet, marrëdhënia në mes të pushtetit konstituiv (**pouvoir constituant**) dhe pushtetit të konstituar (**pouvoir *constitué***) është marrëdhënie në mes të forcës që krijon të drejtën dhe forcës që e ruan atë. Në këtë kuptim, gjykatat kushtetuese paraqiten si pjesë e infrastrukturës institucionale të pushtetit të krijuar që ruan dokumentin kryesor të së drejtës pozitive nacionale – kushtetutën.

[104] Pozita kushtetuese e Gjykatës Kushtetuese është shumë e njëjtë me pothuajse shumicën e modeleve Evropiane. Për karakteristikat themelore të modelit Evropian, cf. më shumë në Herman Schwartz, "Eastern Europe's Constitutional Courts". *Journal of Democracy* Vol. 9 No. 4 (1998) fq. 100-114; Victor F. Comella, "The European model of constitutional Review of legislation: Toward decentralization?". *International Journal of Constitutional Law* Vol. 2 No. 3 (2004) fq. 461-491; Cf. gjithashtu në Luis Lopez Guerra, "The Role and Competences of the Constitutional Court". Në European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *The Role of the Constitutional Courts in the Consolidation of the Rule of Law*. (UniDem Seminar Bucharest, 8-10 June 1994). *CDL-STD (1994) 010*. Në internet: http://www.venice.coe.int/docs/ 1994/CDLSTD(1994)010 e.asp (shikuar në shkurt 2018).

Në fund, funksioni i Gjykatës sipas logjikës **kelseniane**, por jo vetëm, është që të veprojë në rend të parë si një **legjislator negativ,** duke **treguar se çfarë nuk është kushtetuese**.[105] Prandaj, në parim, funksioni i saj është **thjeshtë të rrëzojë akte juridike**, gjatë kontrollit kushtetues, për shkak të kundërshtisë së tyre me Kushtetutën. **Ky rol i legjislatorit negativ përfundon thjeshtë në momentin kur Gjykata Kushtetuese vendos se çfarë nuk është kushtetuese**. Megjithatë, me rolin në rritje të gjyqësisë kushtetuese, ekziston një tendencë që gjykatat kushtetuese të shndërrohen edhe në **legjislator pozitiv,** ku gjykata kushtetuese nuk kufizohet vetëm me vendosjen mbi atë se çfarë **nuk është kushtetuese** por vendos edhe mbi atë se çfarë është (duhet të jetë) kushtetuese,[106] duke **ndërtuar norma të reja dhe faktike kushtetuese** përmes interpretimeve të saj. Këto çështje i diskutojmë në kapitullin e pesëmbëdhjetë, në veçanti në seksionin e tij 15.2., ku flasim për modalitetet e menaxhimit të efekteve juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në aspektin krahasues. Kjo nuk do të thotë se vetëm në sferën e kontrollit abstrakt dhe në atë të kontrollit të veprimeve dhe ometimeve (mosveprimeve) të organeve shtetërore vjen në shprehje roli i gjykatave kushtetuese si ligjvënës pozitiv. Sot mund të shihet se nuk ka kompetencë të gjykatave kushtetuese kelseniane në të cilat nuk ka ardhur në shprehje aktivizimi gjyqësor i gjykatave kushtetuese. Për këtë janë dhënë arsye të ndryshme.

Në doktrinë thuhet që një gjykatë kushtetuese mund të hyjë në terren të aktivizimit gjyqësor **për aq kohë sa është shumë e nevojshme për të ruajtur të drejtat dhe liritë e njeriut**. Ky trend i luajtjes së rolit të ligjvënësit pozitiv, në fakt, është inspiruar nga jurisprudenca e **GJEDNJ**, e cila në shumë raste jep versione vendimesh si legjislator pozitiv, sikur në rastet **Assenov and Others v. Bulgaria, Osman v. the United Kingdom, McCann and Others v. the United Kingdom** etj. etj.[107] *Për të përcaktuar nëse gjykatat kushtetuese vendore mund të dalin në terrenin e* **legjislatorit pozitiv**, **GJEDNJ** ka përcaktuar disa kushte që duhen plotësuar fillimisht, si vijon:

- që, duhet pasur kujdes ndaj një balansi të qartë në mes të interesit të komunitetit/publikut dhe të drejtës së individit;
- që, gjerësia e obligimit pozitiv që vendos gjykata mund të ndryshojë, varësisht nga kontrolli që kërkohet në kuptim të prioriteteve dhe rrethanave në rastin konkret; dhe
- që, obligimi i tillë pozitiv nuk duhet ndërtuar në një mënyrë të tillë që të përbëjë një detyrim të pamundur ose një rëndesë disproporcionale për autoritetin publik mbi të cilin vendoset.[108]

Në kryerjen e rolit të saj si **legjislator pozitiv**, prandaj, Gjykata Kushtetuese është e kufizuar me këto standarde të **GJEDNJ**-së, duke pasur në konsideratë që funksioni origjinal i saj është vetëm i një **legjislatori negativ**, kurse, sipas nenit 53 ["Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut"] të Kushtetutës, ka për detyrë të ndjekë jurisprudencën e Strasburgut.

Në rastin tonë, sikundër çdo kund tjetër në botë, juridiksioni kushtetues reflekton historikun e nevojave dhe qëllimeve konkrete aktuale dhe të së ardhmes që shoqëria synon. Si i tillë, juridiksioni dhe institucioni që e ushtron atë, janë në funksion të realizimit të dizajnit kushtetues, i cili dizajn sanksionohet me Kushtetutën e vitit 2008, supremacinë (epërsinë) e së cilës e siguron vetëm organi i mandatuar për një gjë të tillë – **Gjykata Kushtetuese**. Në këtë kuptim, gjyqësia kushtetuese kosovare ka juridiksion lidhur me çështjet si vijon.

---

[105] Për origjinën e idesë së tillë, cf. Hans Kelsen, *General Theory of Law and State*. (Harvard University Press: Cambridge, MA, 1945) fq. 268-269; Cf. gjithashtu Thomas Bustamante, & Evalinda De Godoi Bustamante, (2010) "Constitutional Courts as 'negative legislators'. The Brazilian case'" *Revista Jurídica Piélagus* Vol. 9 (2010) fq. 137-156;

[106] Cf. Eivind Smith, "Constitutional Courts As 'Positive Legislators' ". *Paper presented at the: International Academy of Comparative Law. XVIII International Congress of Comparative Law*. (Washington, D.C., July 25-31, 2010)

[107] GJEDNJ, **McCann and Others v. the United Kingdom**, § 161; GJEDNJ, **Osman v. the United Kingdom**, §§ 115-117; ose GJEDNJ, **Assenov and Others v. Bulgaria**, §102); Për një trajtim të gjatë krahasues të gjykatave kushtetuese si "legjislator pozitiv", Cf. Allan R. Brewer-Carias, *Constitutional Courts As Positive Legislators.*

[108] GJEDNJ, **Osman v. the United Kingdom**, §§ 115-117 dhe **Rees v. the United Kingdom**, § 37.

- kontrollin abstrakt të normave ligjore[109] dhe kushtetuese,[110] **ex ante** dhe **ex post**, përfshirë kontrollin **ex post** të vendimeve dhe dekreteve individuale të organeve qendrore si dhe rregulloret e tyre që kanë natyrë të aktit të përgjithshëm nënligjor;
- kontrollin incidental të normës, i cili mund të iniciohet nga çdo nivel i gjyqësorit në Kosovë;[111]
- konfliktin për kompetencë, që lind ndërmjet pushtetit qendror dhe autoriteteve të tjera publike në Kosovë;[112]
- vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme dhe veprimeve të ndërmarra gjatë gjendjes së tillë[113];
- kushtetutshmërinë e referendumeve të propozuara[114];
- përputhshmërinë e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, të ratifikuara konform dispozitave kushtetuese, si dhe rishikimin e kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur[115];
- kushtetutshmërinë e zgjedhjeve për Kuvend;[116]
- mbrojtjen gjithëpërfshirëse të të drejtave të autoriteteve lokale **vis-à-vis** autoriteteve qendrore;[117]
- shkeljet e pretenduara të Kushtetutës nga ana e Presidenti i Republikës;[118]
- kushtetutshmërinë e vendimeve individuale të autoriteteve publike kosovare në lidhjen me liritë dhe të drejtat e garantuara me Kushtetutës, përkatësisht të drejtën për **ankesat individuale** pas shterjes së të gjitha mjeteve juridike brenda rendit kushtetues dhe juridik të Kosovës;[119] dhe, në fund,
- çdo lëndë tjetër që si juridiksion shtesë caktohet me ligj.[120]

Të shohim nga afër si duken këto lloje të kompetencave juridiksionale të gjyqësisë kushtetuese kosovare, duke përfshirë këtu jurisprudencën e vetë Gjykatës.

11.3. 1. Juridiksioni nga neni 113. 1 i Kushtetutës

Ky nen nuk përcakton asnjë kompetencë. Me këtë nen përcaktohen parimet themelore të juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese, burimi dhe kufijtë e juridiksionit të saj, si dhe palët proceduralisht të autorizuara për të ngritur çështje përpara saj. Në ndërkohë që neni 112.1 përcakton fizionominë e përgjithshme e gjyqësisë kushtetuese, neni 113.1 shërben si bazë për ushtrimin e juridiksionit të specializuar të **Gjykatës Kushtetuese**. Së bashku me paragrafët tjerë, paragrafi i parë i nenit 113 përbën përcaktorin e juridiksionit të detajuar të Gjykatës, ani se në paragrafin e fundit të këtij neni lejohet që juridiksioni shtesë të mund të përcaktohet edhe me ligje. Kjo qasje ekziston edhe në disa gjykata kushtetuese nëpër botë, gjë që nuk është në rregull sepse një ndër cilësitë dalluese të gjyqësisë kushtetuese është se juridiksioni i saj përcaktohet me kushtetutë, jo me ligj. Këtë e kemi trajtuar gjerësisht në kapitujt pararëndës.

---

109 Neni 113 paragrafi 2 & 5 [“Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara”] i Kushtetutës. Në literaturë, ka autorë kosovar që gabimisht mendojnë se në **Kosovë** nuk ekziston kontrolli preventiv i legjislacionit primar si dhe juridiksioni ndaj vendimeve individuale qeveritare. Cf. Dren Doli & Fisnik Korenica, “Kosovar Constitutional Court’s Jurisdiction: Searching for Strengths and Weaknesses”, fq. 809-810, 814 & 833

110 Neni 113 paragrafi 9 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës.

111 Neni 113 paragrafi 8 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës.

112 Neni 113 paragrafi 3 (1) [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës.

113 Neni 113 paragrafi 3 (3) [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës.

114 Neni 113 paragrafi 3 (2) [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës.

115 Neni 113 paragrafi 3 (4) [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës.

116 Neni 113 paragrafi 3 (5) [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës.

117 Neni 113 paragrafi 4 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës.

118 Neni 113 paragrafi 6 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës.

119 Neni 113 paragrafi 7 [“Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara”] i Kushtetutës.

120 Neni 113paragrafi 10 [“Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara”] i Kushtetutës.

Dy çështjet dalin si të rëndësishme lidhur me nenin 113.1 të Kushtetutës:

- e para, lloji i kontrollit kushtetues që Gjykata mund të ushtrojë, duke përfshirë edhe kufijtë e tij; dhe
- e dyta, aktorët të cilët mund dhe lejohet të iniciojnë procedurën e kontrollit kushtetues para Gjykatës;

Paragrafi i parë i nenit 113 përcakton që Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para saj në mënyrë ligjore dhe nga pala e autorizuar. Ky paragraf është përcaktor i faktit që konkretizimi i juridiksionit të përcaktuar në këtë nen bëhet përmes një ligji që shërben si pikë referimi për të kryer pjesën më të madhe të vlerësimit të rregullsisë procedurale të çështjeve të ngritura në Gjykatën Kushtetuese. E kemi fjalën për **Ligjin nr. 03/L-121,** i cili, së bashku me **RP**, përmban pjesën më të madhe të rregullave procedurale. Edhe në vendet tjera të modelit **evropian/kelsenian**, siç e kemi parë në kapitujt e mëhershëm, ekziston qasja e njëjtë: ana procedurale e gjyqësisë kushtetuese normohet në fillim me kushtetutë, duke marrë kështu karakterin e garancioneve kushtetuese, për t'u operacionalizuar më pas me një ligj organik për gjykatën dhe një rregullore të brendshme. Njëjtë është edhe qasja në Kushtetutën e vitit 2008.

Përveç sa më sipër, ky paragraf ka edhe një kuptim tjetër: asnjë procedurë pranë Gjykatës nuk mund të iniciohet **sua sponte**, përkatësisht **ex officio**, por vetëm mbi bazën e kërkesës së palëve të autorizuara me Kushtetutë dhe ligje. Ky është një standard i afirmuar edhe nga **Komisioni i Venecias.**[121] Në të kaluarën, siç e kemi parë nga kapitujt pararendës, disa gjykata kushtetuese kanë pasur të drejtën e vënies në lëvizje **sua sponte**, me vetiniciativë.[122] Në rastin e Kosovës, ky standard nënkupton se Gjykata ka detyrim për të vendosur vetëm mbi çështjet të cilat plotësojnë kushtet procedurale të specifikuara me Kushtetutë dhe me **Ligjin nr. 03/L-121** e **RP**. Në këtë mënyrë, neni 113.1 është përcaktor i një detyrimi pozitiv për Gjykatën sa i përket rregullsisë procedurale të procedimit të çështjeve, duke i dhënë fuqi një ligji të nxjerrë nga parlamenti që të konkretizojë procedurat e ushtrimit të juridiksionit të përcaktuar me këtë nen. E njëjta vlen edhe për **RP**, si norma të saj të brendshme. Në ndërkohë që një juridiksion kushtetues mund të përcaktohet edhe me një ligj tjetër, siç ka praktikë edhe në vendet tjera, përveç me dispozita kushtetuese. Kjo vlen edhe për palët e autorizuara, të cilat mund të caktohen më ndonjë ligj tjetër të veçantë. Palët e autorizuara janë kryesisht vetëm ato të përcaktuara nga neni 113, paragrafët 2-8, kurse procedurat e ushtrimit të juridiksionit kushtetues përcaktohen me Kushtetutë, kurse specifikohen me **Ligjin nr. 03/L-121** dhe **RP**. Nuk përjashtohet mundësia që, në një të ardhme, të përcaktohet juridiksion shtesë me palë tjera të autorizuara prej atyre që janë dhënë në nenin 113, paragrafët 2-8 si më sipër. Këto janë spekulime teorike për momentin, por jeta mund të sjellë risi në këtë drejtim, marrë parasysh në veçanti faktin që ende nuk e kemi mbyllur marrëdhënien tonë të komplikuar me fqinjin verior – **Serbinë**.

11. 3. 2. Juridiksioni nga neni 113. 2 (pikat 1 dhe 2) i Kushtetutës

Neni 113.2 përcakton juridiksionin kryesisht **abstrakt**,[123] sa i përket kontrollit kushtetues të ligjeve, statutit të komunës, dekreteve të presidentit dhe kryeministrit dhe rregulloreve të qeverisë. Në kuptim të nenit 113.2, ekzistojnë katër subjekte të autorizuara për të ngritur para Gjykatës Kushtetuese çështjen e

---

[121] Cf. European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), "Opinion on the Draft Law on the Constitutional Court of Montenegro." Adopted by the Venice Commission at its 76th Plenary Session (Venice, 17-18 October 2008). *Opinion 479 / 2008 CDL-AD(2008)030* Original: English (Strasbourg, 24 October 2008). Paragrafët: 80 & 84.

[122] Cf. seksioni 5.1, në kapitullin e pestë, që flet kryesisht për **Jugosllavinë** dhe vendet e dala nga shpërbërja e saj në vititn 1992.

[123] Kontrolli abstrakt kundërshtohej fuqishëm në **Letrat e Federalistit**, meqë shihej si mundësi e kundërbalancimit të vullnetit popullor. Që nga kjo kohë, në doktrinë kjo dilemë njihet si dilema kundër-mazhoritare, për të cilën kemi folur më heret. Cf. Barry Friedman, "The History of the Counter majoritarian Difficulty, Part Four. Law's Politics". *University of Pennsylvania Law Review* Vol. 148 No. 4 (April, 2000) fq. 971-1064; Në rastin e **Kroacisë**, **Gjykata Kushtetuese** ka vlerësuar se nuk ka juridiksion të vlerësojë përputhshmërinë e akteve "ordinare" dhe organike me aktet kushtetutës nëse këto akte jane 'kushtetuese' vetëm në emër, dhe nuk janë nxjerrë në përputhje me procedurat e përcaktuara për ndryshimin e Kushtetutës. Prandaj, për nga natyra e tyre juridike dhe përmbajtja, nuk mund të konsiderohen akte kushtetuese me fuqi të Kushtetutës. (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë U-I-3760/2007 et al, i datës 08.12.2010).

kushtetutshmërisë së ligjeve, statutit të komunës, dekreteve të presidentit dhe të kryeministrit dhe rregulloreve të qeverisë, që janë: **Kuvendi i Kosovës**, **Presidenti i Republikës**, **Qeveria** dhe **Avokati i Popullit**.

Çështja e parë që duhet konsideruar është numri dhe aktorët që mund të bëjnë ngritjen çështjeve për kontroll kushtetues, kryesisht abstrakt, para Gjykatës Kushtetuese. Në rend të parë, ky paragraf nuk lejon hapësirë, apo nuk përcakton autorizim, që personat (fizikë apo juridikë) të mund të iniciojnë procedurën e kontrollit abstrakt para Gjykatës Kushtetuese. Me fjalë të tjera, **actio popularis** nuk lejohet sipas paragrafit të tillë, që nënkupton se personat nuk mund të iniciojnë para Gjykatës Kushtetuese çështje të kontrollit kushtetues abstrakt. Ky lloj mjeti juridik, **actio popularis**, sot paraqet një praktikë të rrallë nëpër botë: edhe aty ku ka ekzistuar, siç është rasti i **Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë**, ai është braktisur. Aktualisht nuk përbën standard evropian në gjyqësinë kushtetuese të **modelit kesenian** dhe është kritikuar ashpër nga **Komisioni i Venecias.**[124] Në anën tjetër, ky paragraf nuk vendos kurrfarë kushti për katër subjektet e autorizuara për të ngritur çështjen e kontrollit kushtetues para Gjykatës në kuadër të juridiksionit të përcaktuar me këtë paragraf. Kjo do të thotë se paragrafi në fjalë nuk kërkon që institucionet e përmendura të kenë **interes direkt juridik** në çështjen kushtetuese që të mund ta ngrinin para Gjykatës, apo edhe që të plotësojnë ndonjë kusht tjetër. Në këtë kuptim, katër subjektet e autorizuara janë plotësisht të lira që të sfidojnë çdoherë kushtetutshmërinë e akteve juridike si më sipër para Gjykatës, pa pasur nevojë të plotësojnë ndonjë kusht specifik. Këto palë ndryshe njihen në doktrinë si **palë të privilegjuara**, pikërisht për këtë arsye: nuk kanë nevojë të provojnë ekzistimin e interesit juridike për të sfiduar kushtetutshmërinë e akteve përkatëse juridike.

Në rastet e kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë, një rast mund të jetë i pranueshëm **ratione personae**, mirëpo Gjykata të mos ketë juridiksion **ratone materiae**. Kështu, ta zëmë, ka qenë rasti me kontrollin kushtetues të **Marrëveshjes së Parë me Serbinë.**[125] Kjo është kështu sepse te **kontrolli abstrakt** mjafton që pala e autorizuar të ketë statusin e palës së privilegjuar kushtetuese, siç janë, në rastin e Kosovës, Presidenti, Qeveria, Avokati i Popullit, Kuvendi dhe Komuna. **Palë e privilegjuar është ajo që nuk ka nevojë të provojë para një gjykate kushtetuese ekzistimin e interesit juridik për nisjen e procedurave të kontrollit abstrakt**. Kjo është kështu në çdo vend që ka juridiksion të ndarë kushtetues, të centralizuar dhe që ushtrohet nga një gjykatë e veçantë e veshur me juridiksion të kontrollit abstrakt të normës juridike. Në aspektin **ratione materiae**, megjithatë, duhet të ekzistojë një juridiksion i qartë material që autorizon gjykatën përkatëse kushtetuese për të shqyrtuar dhe vendosur mbi meritat e rastit. Në **Kosovë**, një juridiksion i tillë nuk ekziston, ta zëmë, sa i përket kontrollit kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare: internalizimi i marrëveshjeve dhe detyrimeve tjera ndërkombëtare në **Kosovë** bëhet përmes ratifikimit ligjor. Vetë ligji ratifikues nuk ka asnjë vlerë normative dhe kryen vetëm një funksion - futjen në sistemin e brendshëm juridik të një marrëveshjeje dhe detyrimi ndërkombëtar të vendit. Ky është standardi i shumicës së shteteve evropiane dhe i vendeve të tjera ku kultivohet gjyqësia kushtetuese e modelit evropian/kelsenian, në **Amerikë Latine, Azi Qëndrore, Turqi** dhe në **Lindje të Largët.**[126]

Sa i përket të palës së parë të autorizuar, **Kuvendit të Kosovës**, ky paragraf në shikim të parë mund të kuptohet si diçka që i mundëson atij që, sipas procedurës së vet të brendshme, me një shumicë votash, të mund të iniciojë para Gjykatës kontrollin kushtetues të ligjeve,

---

[124] European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Opinion on Three Legal Questions in the Process of Drafting the New Constitution of Hungary*. Adopted by the Venice Commission at its 86th Plenary Session (Venice, 25-26 March 2011). *Opinion no. 614/2011*. CDL-AD(2011)001. Original. English (Strasbourg, 28 March 2011). Paragrafët. 57-59.

[125] Cf. fusnotat nr. **55-60** në kapitullin e 12-të të këtij libri.

[126] Për keqkuptim drastik të konceptit të palës së privilegjuar, pranueshmërisë dhe mospranueshmërisë së rastit kur për palë ka një subjekt të privilegjuar, si dhe të standardit **kelesenian/evropian** i cili, në parim, nuk e preferon kontrollin kushtetues të marrëveshjeve dhe detyrimeve tjera ndërkombëtare, cf. më shumë në Dren Doli, Fisnik Korenica & Albana Rexha, *Promising Early Years: The Transformative Role of the Constitutional Court of Kosovo* (Analitika: Center for Social Research, Sarajevo, 2015) fq. 44-48.

statutit të komunës, dekreteve të presidentit dhe kryeministrit dhe rregulloreve të Qeverisë.[127] Kjo, megjithatë, nuk është kështu. Ky juridiksion, krahas atij që ka të bëjë me konfliktin për kompetencë dhe federalizmin (ndarjen vertikale të pushtetit),përbën thelbin e fizionomisë së gjyqësisë kushtetuese të modelit **evropian/ kelsenian**: ky juridiksion nuk ka për qëllim shfuqizimin e ligjeve me shumëcë të votave nga ana e ligjvënësit, por mbrojtjen e pakicë parlamentare nga pushteti i shumicës, nga veprimi administrativ i qeverisë dhe nga mosfunksionimi në bazë të Kushtetutës i Presidentit të Republikës dhe i pushtetit lokal. Në frymën e këtij juridiksioni klasik të gjyqësisë kushtetuese janë draftuar edhe dispozitat e **Ligjin nr. 03/L-121**. në nenin 29.1 **që flet për procedurat në rastet e përcaktuara në nenin 113, paragrafi 2, në pikat 1 dhe 2 të Kushtetutës, cakton** një të katërtën (1/4) e deputetëve si palë në këtë procedurë. Këtu nuk ka asnjë rëndësi përkatësia partiake: me rëndësi janë një e katërta (1/4) e deputetëve që të vejnë nënshkrimin dhe të dërgojnë në Gjykatë secilin prej akteve juridike të përcaktuara me nenin 113.2 të Kushtetutës. Kjo zgjidhje kushtetuese, e specifikuar me nenet 29 dhe 30 të **Ligjin nr. 03/L-121,** ekziston sipas standardeve të demokracive kushtetuese, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e pakicave parlamentare nga tirania e shumicës. Në të njëjtën kohë, autorizimi i Kuvendit që të kërkojë kontrollin e kushtetutshmërisë së dekreteve të presidentit, kryeministrit, statutit të komunës por edhe rregulloreve të Qeverisë i shërben konceptit që Kuvendi të mund të prodhojë përmes aktivitetit të vet një procedurë përmes së cilës e kundërbalancon një akt jo-kushtetues të tre institucioneve të tjera. Por, kjo vlen edhe për kërkesën për vlerësim të kushtetutshmërisë së prodhimeve të Kuvendit nga ana e Qeverisë, Presidentit dhe Avokatit të Popullit.

Në pozicionin e tij si palë e autorizuar për të iniciuar kontrollin e kushtetutshmërisë për këto akte juridike, Kuvendi është i kufizuar me kohë: sipas nenit 30 të **Ligjin nr. 03/L-121,** ai mund ta ushtrojë këtë të drejtë brenda periudhës kohore prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar. Në literaturë, llojet e gjykimeve që zhvillohen ngjashëm me procedurat sipas nenit 113.2 të Kushtetutës, cilësohen si procedura që kanë për qëllim mbrojtjen e kushtetutës për dallim nga procedurat tjera që zhvillohen sipas kërkesave individuale dhe që kanë për qëllim interpretimin e kushtetutës.[128] Ne më sipër sqaruam, megjithatë, se kjo është gabim sepse pikërisht në rastet e këtyre procedurave bëhet fjalë për interpretim kushtetues. Kjo nuk vlen vetëm për rastin e juridiksionit që diskutohet në këtë seksion. Me **interpretim kushtetues** nënkuptohet ai operacion mendor që kryhet si interpretim abstrakt nga neni 113 i Kushtetutës, paragrafët si vijon: 2 (pikat 1 & 2), 3 (pika 4), 4, 5, 8 & 9 (**constitutional interpretation**), në ndërkohë që procedurat sipas nenit 113.7 i Kushtetutës janë procedura që kanë natyrën e kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë (**constitutional review**).

Sa i përket të autorizuarit të dytë, Qeverisë, ky paragraf lë të kuptohet që kjo e fundit, si një organ kolektiv, duke vendosur me një shumicë votash mund të iniciojë kontrollin kushtetues para Gjykatës Kushtetuese. Duke e shfrytëzuar këtë të drejtë, Qeveria mund të kontestojë kushtetutshmërinë e një ligji të Kuvendit si mënyrë e kundërbalancimit të tij përmes inicimit të kontrollit të aktit të nxjerrë nga përfaqësuesi i sovranit. Qeveria është e autorizuar ta bëjë të njëjtën iniciativë, pra të sfidojë kushtetutshmërinë e statutit të një komune, një dekreti të presidentit të republikës dhe të vetë kryeministrit. Pyetje bazike në këtë rast mund të jetë se ku është logjika prapa autorizimit të Qeverisë që të kërkojë kontrollin e një dekreti të kryeministrit, për aq kohë sa ky i fundit është vet shefi i Qeverisë? Logjika pas këtij autorizimi lidhet me faktin që një kryeministër, megjithatë, në kuadër të një qeverie koalicioni mund të

---

[127] Si shembull, në **Brazil**, Gjykata Federale Supreme hodhi poshtë një kërkesë, duke theksuar se efekti **erga omnes** i kontrollit gjyqësor nuk e obligon edhe pushtetin legjislativ. Ai efekt obligon vetëm ekzekutivin dhe gjyqësorin. Legjislativi është i lirë të nxjerrë akte legjislative me përmbajtje të ngjashme me cilindo ligj që mund të jetë shpallur jo-kushtetues nga Gjykata Supreme (Vendim i **Gjykatës Federale Supreme të Brazilit**, Nr. 2617 i datës 23.2.2005).

[128] Cf. Luis Lopez Guerra, "The Role and Competences of the Constitutional Court", fq. 20-23.

mos e ketë në dorë kontrollin e Qeverisë, prandaj, nën këtë autorizim, një shumicë votash e Qeverisë në fakt mund ta sjellin një dekret të kryeministrit para Gjykatës Kushtetuese për kontroll kushtetues. Ky argumentim, megjithatë, ka natyrë politike dhe ekstra-kushtetuese: argumenti kryesor kushtetues i kësaj logjike qëndron në faktin se me Kushtetutë janë të ndara kompetencat e kryeministrit dhe të qeverisë. Në ndërkohë që në nenin 93 të Kushtetutës flitet për kompetencat e qeverisë si organ kolegjial, në nenin në vijim bëhet fjalë për një numër kompetencash të kryeministrit si organ inokos. Për aq sa këto kompetenca janë të ndara dhe të rregulluara me kushtetutë, ato duhet t'i nënshtrohen kontrollit kushtetues dhe. si palë e autorizuar, mund të paraqitet vetë qeveria kundrejt shefit të vet, por jo edhe anasjelltas sepse dispozita e nenit 113.2 (1) flet për sfidimin e dekretit dhe rregulloreve të Qeverisë: në ndërkohë që dekreti është prerogativë e shefit të Qeverisë, rregulloret si akte abstrakte qeveritare miratohen me vendim kolektiv të ekzekutivit. Edhe vetë vendimi për të adresuar kërkesë në Gjykatën Kushtetues përbën një vendim të natyrës kolektive, përkatësisht kryeministri nuk mund t'i drejtohet vetë Gjykatës Kushtetues me kërkesë kushtetuese. Kjo përbën një argument shtesë në favor të teorisë sonë mbi mundësinë që një shumicë e ekzekutivit kosovar të votojë për ta dërguar dekretin e shefit të tyre për kontroll kushtetues në Gjykatën Kushtetuese. Krejt kjo që u tha këtu, përbën vetëm një shtjellim teorik sepse në praktikë kjo nuk duket që ka logjikë, sepse Qeveria pa kryeministër nuk mund të ekzistojë dhe do të ishte vërtetë absurde që dekretet e kryeministrit të sfidoheshin në Gjykatën Kushtetuese, me një vendim qeveritar, kurse vetë shefi i ekzekutivit të qëndrojë në detyrë.

Në disa raste, si p.sh. në **Slloveni**, një mundësi e tillë përjashtohet në mënyrë shprehimore. duhet të pajtohemi me autorët që e vejnë në dyshim mundësinë e sfidimit të dekreteve të kryeministrit kosovar nga një shumicë e anëtarëve të vetë organit shef i të cilët është ajo/ai.[129] Këtë dispozitë, përkatësisht dispozitën e nenit 113.1 (1) të Kushtetutës duhet kuptuar si një prerogativë që i takon katër organeve që përmenden aty për t'ia sfiduar reciprokisht njëri tjetrit përmes Gjykatës Kushtetuese aktet juridike - ligjet, dekretet (presidenciale dhe të kryeministrit) dhe rregullativën tjetër qeveritare që çdoherë përmban norma të karakterit abstrakt.

Sa i përket palës së tretë të autorizuar, paragrafi e autorizon në mënyrë eksplicite **Presidentin e Republikës** që të kërkojë kontrollin e kushtetutshmërisë së akteve përkatëse para Gjykatës Kushtetuese. Ky autorizim i shërben konceptit të ndarjes së pushteteve dhe kundërbalancimit të tyre, meqë e drejta e Presidentit në këtë rast shihet si rrugë përmes së cilës ai/ajo e ushtron rolin e saj/tij kundërbalancues ndaj pushteteve tjera.

Sa i përket të autorizuarit të katërt, ky paragraf e autorizon **Avokatin e Popullit** që të ketë të drejtën e iniciativës në kërkesën për kontrollin e kushtetutshmërisë së akteve përkatëse. Duhet thënë që, prej të gjithë aktorëve në kuadër të këtij paragrafi, vetëm **Avokati i Popullit** është aktor institucional jopolitik dhe i pavarur që është i veshur me të drejtën e iniciativës për kontroll të kushtetutshmërisë së akteve përkatëse. Logjika prapa kësaj formule është që një aktor institucional i pavarur, misioni i të cilit është mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut, të ketë legjitimitetin procedural për të kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së akteve përkatëse përpara Gjykatës Kushtetuese. Shikuar në kuptimin e një **actio popularis,** që ky paragraf e ndalon praktikisht, iniciativa që mund të ngrejë **Avokati i Popullit** është, megjithatë, një rrugë përmes së cilës ky i fundit mund të shprehë një brengë qytetare përgjatë ushtrimit të së drejtës së tij. Prandaj, iniciativa që bart **Avokati i Popullit,** duhet shikuar edhe nga këndi i mundësisë që ky, duke kanalizuar kërkesat individuale qytetare, të iniciojë kontrollin e kushtetutshmërisë së akteve përkatëse sipas iniciativës së tij në kuptim të këtij paragrafi. Modeli i ngjashëm me modelin kosovar ekziston edhe në vendet tjera, sikurse ta zëmë, në **Portugali**, ku organet jopolitike mund të paraqiten si palë në procedurë.[130]

---

[129] Dren Doli & Fisnik Korenica, "Kosovar Constitutional Court's Jurisdiction: Searching for Strengths and Weaknesses ", fq. 812.

[130] Cf. Michele Belleti, "Il sistema di justizia costituzionale portoghese". Në Luca Mezzetti (ed.), *Sistemi e Modeli di Giustizia Costituzionale*, fq. 267-29.

Për fund, sa i përket të autorizuarve sipas këtij paragrafi, është e rëndësishme të thuhet që **actio popularis** nuk gjen shprehje në kushtetutën tonë dhe se kontestimi direkt nga ana e personave i një akti abstrakt nuk është i mundur. në kuptim të këtij paragrafi, iniciativa për ngritjen e kontrollit të kushtetutshmërisë është thjeshtë monopol i institucioneve shtetërore. Ky monopol përfshin thjeshtë një rreth shumë të ngushtë institucionesh, tre prej të cilave janë aktorë politikë institucionalë, përderisa vetëm njëri nga ta është aktor institucional i pavarur dhe jopolitik. Siç mund të vërehet, ky paragraf nuk lejon hapësirë as për iniciativa qytetare (si kolektive ashtu edhe individuale) për kontroll të kushtetutshmërisë së akteve përkatëse. Shikuar si tërësi, e drejta e ngritjes së iniciativës për kontroll të kushtetutshmërisë së ligjeve, statutit të komunës, dekreteve të presidentit dhe kryeministrit, dhe të rregulloreve të Qeverisë është pothuajse instrument thjeshtë i vënë në kuptim të sendërtimit të kontrollit të ndërvarur që secila nga këto institucione i bëjnë tjetrës. E vënë në kontekstin teorik, kjo ngushtësi institucionale përmes së cilës mund të rrjedhë iniciativa për kontroll të kushtetutshmërisë së këtyre akteve lejon mundësinë që Gjykata Kushtetuese të mos jetë objekt i kërkesave të tepërta për kontroll abstrakt, dhe që roli i saj subsidiar të jetë i dizajnuar më fuqishëm.

Përveç palëve të autorizuara sa i përket këtij paragrafi, i rëndësishëm për konsideratë është edhe çështja e llojit të akteve që mund t'i shtrohen kontrollit të kushtetutshmërisë sipas këtij paragrafi. Gjykata Kushtetuese këtu vishet me autoritetin e kontrollit vetëm të kushtetutshmërisë, duke qëndruar në kufijtë tipikë të një juridiksioni kushtetues **evropian/kelsenian**. Në anën tjetër, aktet juridike që mund t'i nënshtrohen kontrollit të kushtetutshmërisë, janë: ligjet, dekretet e presidentit dhe kryeministrit, rregulloret e Qeverisë dhe statutet e komunave. Sa i përket kategorisë së akteve juridike të formës së ligjit, Gjykata ushtron kontrollin e përputhshmërisë abstrakte të aktit ligjor me kushtetutën, që është në fakt juridiksioni që përbën **raison d'être** të gjyqësisë kushtetuese kelseniane.[131] Ky kontroll, në kuptim të këtij paragrafi, është i tipit klasik **represiv (ex posto)** që nënkupton se ai mund të ushtrohet vetëm pasi që të jetë nxjerrë dhe të ketë hyrë në fuqi ligji i kontestuar.[132]

Sa i përket dekretit të **Presidentit të Republikës**, këtu Gjykata vishet me të drejtën e ushtrimit të kontrollit të një akti juridik individual, meqë dekreti në parim është akt juridik që zgjidh një situatë individuale. Në këtë aspekt, Gjykata bën kontrollin e aktit juridik ekzekutiv, që ka formën e dekretit, të Presidentit të Republikës, duke ushtruar në fakt një lloj të kontrollit individual/konkret. I njëjti koment mund të jepet edhe sa i përket Kryeministrit. Logjikisht, koncepti **dekret** i përdorur në këtë paragraf i referohet çdo akti juridik individual përmes së cilit Presidenti apo Kryeministri e ushtrojnë një të drejtë të tyre kushtetuese. Në këtë rast, koncepti **dekret** përfshin të gjithë listën e akteve juridike individuale që nxjerrin të dy institucionet shtetërore, pavarësisht se si i vihet emri formal aktit të tillë nga ana e institucionit përkatës. I njëjti problem paraqitet në rastin e konceptit **rregullore**, i përdorur nga ky paragraf i Kushtetutës. Pyetja që shtrohet këtu, është kjo: a përfshin ky juridiksion thjeshtë vetëm aktet juridike të Qeverisë që kanë formë e rregullores, apo çdo akt juridik i përgjithshëm që nxjerr Qeveria? Nuk ka arsye që Gjykata të ketë juridiksion të ushtrojë kontrollin e kushtetutshmërisë së dekreteve të kryeministrit e të jetë, në të njëjtën kohë, e kufizuar vetëm në ushtrimin e kontrollit të kushtetutshmërisë së akteve juridike qeveritare që kanë formën e rregullores. Shikuar në këtë aspekt, koncepti **rregullore** i shfrytëzuar nga ky paragraf nënkupton të gjitha aktet juridike të Qeverisë që kanë substancë abstrakte, siç janë udhëzimet, direktivat etj.[133]

---

131 Luis Lopez Guerra, "The Role and Competences of the Constitutional Court", fq. 20-23.

132 Shih më shumë mbi kontrollin represiv, në: Helmut Steinberger, "Models of Constitutional Jurisdiction" Në European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Science et technique de la démocratie no. 2. CDL-STD(1993)002*. Original. English (Strasbourg 1993). Në internet: http://www.venice.coe. int/ web forms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-STD(1993)002-e (shikuar në shkurt 2018).

133 Cf. më shumë për këtë në Dren Doli & Fisnik Korenica, "Kosovar Constitutional Court's Jurisdiction: Searching for Strengths and Weaknesses", fq. 803-836.

Thënë ndryshe, sipas interpretimit teleologjik të këtij paragrafi, çdo akt juridik i përgjithshëm që buron nga pushteti ekzekutiv (rregullore, udhëzime administrative, direktiva etj.) si dhe çdo akt juridik individual i po këtij pushteti (dekret, vendim ekzekutiv etj. etj.) hyjnë në listën e akteve juridike që i nënshtrohen kontrollit kushtetues nga ana e **Gjykatës Kushtetuese.**

Juridiksioni i Gjykatës që ka të bëjë me kontrollin kushtetues të **statutit komunal** lidhet me sigurimin e unitetit politik dhe territorial të Republikës së Kosovës. Argumenti këtu është që komunat janë të veshura me autoritet të bartur sipas Kushtetutës për vetëqeverisje lokale, përkatësisht janë një zinxhir shumë i rëndësishëm në ndarjen vertikale të pushtetit, por që kanë kufij kushtetues shumë qartë të përcaktuar: **tejkalimi i këtyre kufijve të vetëqeverisjes lokale përbën shkelje të karakterit unitar të Republikës së Kosovës.** Këtë aspekt e shikon Gjykata me rastin e ushtrimit të kontrollit të kushtetutshmërisë së statuteve të komunave, pra situatat kur mendohet që ato kanë tendencë për të tejkaluar parimet e vetëqeverisjes lokale apo për të përvetësuar autoritet qendror, apo thjeshtë për të cenuar natyrën unitare të shtetit. Kontrolli kushtetues në këtë rast arsyetohet me detyrimin e ruajtjes së kufijve kushtetues të vetëqeverisjes lokale dhe integritetit e unitetit territorial dhe administrativ të shtetit. Në anën tjetër, ruajtja e të drejtave për vetëqeverisje lokale të komunave nga uzurpimi i organeve qendrore, është gjithashtu i mbrojtur dhe përbën pjesë të juridiksionit të Gjykatës, që diskutohet në vijim në kuadër të një paragrafi tjetër të mëposhtëm të Kushtetutës. Në jurisprudencën e Gjykatës deri më sot ka pasur vetëm një rast që është trajtuar çështja e kontrollit kushtetues të kufijve dhe mënyrës së ushtrimit të **vetëqeverisjes lokale**. Ky rast, megjithatë, nuk ka pasur të bëjë me statutin e komunës por me kontrollin kushtetues të synimeve për uzurpim të pushtetit qendror nga ana e serbëve të Kosovës përmes krijimit të një asociacioni të komunave me shumicë serbe. Këtë rast e kemi diskutuar më gjerësisht në seksionin e shtatë të kapitullit të gjashtëmbëdhjetë të librit, por edhe më poshtë në vijim të këtij kapitulli.

11. 3. 3. Juridiksioni nga neni 113. 3 (pikat 1 deri 5) i Kushtetutës

Neni 113.3 përcakton juridiksionin e Gjykatës sa i përket kontrollit kushtetues të **konfliktit për kompetencë** kushtetuese në mes të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës dhe Qeverisë, kontrollit kushtetues të referendumit të propozuar, kontrollit kushtetues të gjendjes së jashtëzakonshme, kontrollit kushtetues të amendamenteve kushtetuese sa i përket përputhshmërisë së tyre me marrëveshjet ndërkombëtare (**kontrolli i konvencionalitetit**), dhe kontrollit kushtetues të zgjedhjeve për Kuvend. Në përgjithësi, neni 113.3 përbën një hapësirë mjaft të gjerë jurisdiksionale të Gjykatës që prek shumë çështje të rëndësishme.

Në kuptim të dispozitës së nenit 113.3, vetëm tre aktorë institucional janë të autorizuar që të iniciojnë çështje para Gjykatës. Këta janë: Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës dhe Qeveria. Për të diskutuar pozitën e secilës palë të autorizuar, për secilin juridiksion të specializuar që rrjedh nga ky nen, nevojitet që një nga një ti shqyrtojmë pikat 1-4 të këtij neni.

Sipas **pikës së parë** të nenit 113.3., Gjykata është e autorizuar që të zgjidhë konfliktin për kompetencë kushtetuese në mes të Kuvendit, Presidentit dhe Qeverisë, sipas kërkesës së njërit nga ta. Në kuptim të këtij juridiksioni, rrethi i institucioneve që mund të kërkojnë zgjidhje të konfliktit për kompetencë në Gjykatë është relativisht i ngushtë. Ai rreth përfshin vetëm institucionet politike të shtetit, që, në njëfarë mënyrë, përbën një mekanizëm për kontrollim të balancit kushtetues në mes të pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, në njërën anë, dhe Shefit të Shtetit, në anën tjetër. Në këtë kuptim, ky juridiksion i jep autoritet Gjykatës që të ruajë balancin kushtetues në aspektin real të kufijve të autoritetit të secilit nga institucionet e mësipërme, duke garantuar që logjika kushtetuese mbi ndarjen e pushtetit dhe kundërbalancimin e ndërvarur të kontrollohet dhe garantohet nga një mekanizëm i pavarur që quhet gjyqësi kushtetuese. Sa i përket logjikës prapa këtij juridiksioni, duhet thënë që shpeshherë përcaktimet kushtetuese mbi kompetencat e institucioneve shtetërore tejkalohen apo ndryshohen **de facto** nga uzurpimi i prerogativave që in-

stitucionet përkatëse i kryejnë duke u bazuar në fuqinë faktike që disa syresh mund ta kenë. Prandaj, ky juridiksion special vendos garancionin që prerogativat e marra nga njëri prej këtyre tri institucioneve në mënyrë kundërkushtetuese të mund të rrëzohen nga Gjykata Kushtetuese ashtu që fuqia faktike e njërit institucion të mos jetë hapësirë për uzurpim të kompetencave kushtetuese të institucionit tjetër. Duhet thënë që koncepti **kompetencë** i shfrytëzuar në këtë pikë të këtij paragrafi i referohet jo thjeshtë **konfliktit pozitiv për kompetencë,** por edhe **konfliktit negativ për kompetencë** në mes të këtyre tri institucioneve.

Është e rëndësishme të thuhet që ky juridiksion i Gjykatës përfshin vetëm zgjidhjen e konfliktit për kompetencë kushtetuese, duke mos hyrë në kompetencat që mund të jenë përcaktuar me anë të ligjit apo akteve tjera juridike. Shikuar në këtë kontekst, Kuvendi, sipas këtij juridiksioni, realisht nuk mund që, duke shfrytëzuar funksionin e tij legjislativ, t'ia okupojë një kompetencë Presidentit të Republikës apo Qeverisë, apo edhe që ta shfrytëzojë funksionin e tij legjislativ duke hyrë në kufijtë e autoritetit të dy institucioneve tjera. Ky juridiksion parandalon mundësinë që të ketë një hapësirë për luftë për kompetenca në mes të tri institucioneve sepse Gjykata shërben si forumi i vetëm me kompetencë për zgjedhjen e tyre. Sipas rregullit, kjo procedurë do të duhej të ishte shumë e shpejtë. Ky, megjithatë, nuk është rasti. neni 32 ["Afat"] i **Ligjin nr. 03/L-121** nuk flet për afatin kohor brenda të cilit duhet të zgjidhet konflikti për kompetencë, por vetëm për afatin gjashtë (6) mujor brenda të cilit duhet të parashtrohet kërkesa nga pala e autorizuar (sic!). Ky përcaktim ligjor nënkupton se koha e vendosjes është në mëshirë të vlerësimit të Gjykatës të urgjencës së rrethanave të rastit të krijuar.

Nga si më sipër, del se ka rëndësi shumë të madhe që **konflikti për kompetencë** kushtetuese të jetë real, jo **fiktiv** dhe **imagjinar**. Kjo nënkupton se duhet të ekzistojë një akt juridik apo fakt, një veprim ose mosveprim i njërit prej tri organeve të sipërcekura, që dëmton sferën e veprimtarisë së tij të garantuar me Kushtetutë. Në një rast të vendosur nga Gjykata Kushtetuese, të cilin gjerësisht e diskutojmë në kapitullin e fundit, në seksion e tij të njëmbëdhjetë, është konstatuar se **Presidenti i Republikës** ka ngritur si çështje kushtetuese të natyrës së konfliktit për kompetencë një situatë që fare nuk ka ekzistuar në praktikë. Këtë ngritje **fiktive** dhe të **imagjinuar**, Presidenti e ka bërë, në përpjekjet e tij për të sfiduar krejtësisht diçka tjetër, një marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare sipas nenit 18.2 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushteutës.

Pika e dytë e nenit 113.3 përcakton juridiksionin e Gjykatës në lidhje me kontrollin e kushtetutshmërisë së referendumit të propozuar. Është e rëndësishme të thuhet që në kuptim të **modelit konsociacional të demokracisë** (**consotiational democracy**) që e vendos Kushtetuta e vitit 2008, kontrolli kushtetues i referendumit është pikë shumë thelbësore për ruajtjen e këtij modeli të demokracisë.[134]Në ushtrimin e këtij juridiksioni, Gjykata duhet që të marrë në konsideratë dy çështje: një, nëse referendumi është shpallur sipas nenit 65.3 ["Kompetencat e Kuvendit"] të Kushtetutës, që ka të bëjë me shpalljen e tij nga ana e organit të autorizuar dhe në pajtim me ligjin; dhe, dy, nëse referendumi është në linjë me ndalesën e nenit 81.2 të Kushtetutës, me të cilin ndalohet që **ligjet me interes vital** të nxirren në referendum.[135]

Këtu çështja e dytë është pika më e rëndësishme meqë shpallja e referendumit, sipas nenit 81.2, është e ndaluar për **ligjet me interes vital**, të përcaktuara sipas paragrafit paraprak të nenit të njëjtë, nenit 81. Ky

---

[134] Fisnik Korenica & Dren Doli, "The Politics of Constitutional Design in Divided Societies: The Case of Kosovo". *Croatian Yearbook of European Law and Policy*. Vol. 6 No. 6 (2010) fq. 265-292; Shih më shumë për ndërlidhjen e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të popullit në vendimmarrje sa i përket këtij modeli të demokracisë në: Arend Lijphart, *The Politics of Accommodation: Pluralism and Democracy in the Netherlands*.(University of California Press: LA, 1968); Për përpjekjet e para për ta definuar këtë çështje, cf. Arendt Lijphart, "Consociational Democracy". *World Politics*. Vol. 21 Issue (January, 1969) fq. 207-225; Cf. Po ashtu Kenneth D. McRae, *Consociational Democracy: Political Accommodation in Segmented Societies*. (McClelland and Steëart Toronto, 1974); Arend Lijphart, *Democracy in Plural Societies* (Yale University Press: New Haven, 1977); Arend Lijphart, "Consociation and Federation: Conceptual and Empirical Links". *Canadian Journal of Political Science*. Vol. 12 Issue 3 (September, 1979) fq. 499-515; Arend Lijphart (ed), *Conflict and Coexistence in Belgium: the Dynamics of a Culturally Divided Society*. (Institute of International Studies. University of California: Berkely, 1981); Arend Lijphart, *Thinking about Democracy. Power-sharing and Majority Rule in Theory and Practice*. (Routledge: New York, 2008)

[135] Neni 81.2 [Legjislacioni me Interes Vital] i Kushtetutës:
"[…] 2. Asnjëri nga ligjet me interes vital, nuk mund t'i nënshtrohet referendumit."

kontroll kushtetues, prandaj, është një mekanizëm që i mbron **ligjet vitale prej votës së shumicës së popullit** dhe paraqet cilësinë themelore të modelit **konsociacional të demokracisë** në sistemin kushtetues të **Kosovës.** Si **ligje vitale**, të cilat janë cilësi e kësaj demokracie kosovare, janë ligjet që kërkojnë votimin e dyfishtë në Kuvend për ndryshimin, miratimin apo shfuqizimin e tyre. Me votim të dyfishtë nënkuptohet shumica e të gjitha votave të përfaqësuesve të komuniteteve jo shumicë në Kuvend.[136] Ky votim i dyfishtë ka të bëjë me substancën e këtyre ligjeve vitale sepse, si të tilla, janë qenësore për pozitën e komuniteteve jo shumicë dhe pjesëtarëve të tyre në sistemin kushtetues të Kosovës. Në kuptim të këtij juridiksioni, Gjykata është mekanizmi që duhet të garantojë që parimi kushtetues i mbrojtjes së ligjeve vitale nga referendumi të mbikëqyret dhe, si rrjedhojë, të mbrohet **modeli konsociacional i demokracisë** që prodhon Kushtetuta e vitit 2008.

Vlen të theksohet se deri më sot Kosova ende nuk ka nxjerrë një ligj për **referenduimin**. Përmbajtja e tij, siç mund të imagjinohet, nuk mund të jetë kundër dispozitave kushtetuese që flasin jo vetëm për ndalesën shprehimore lidhur me ligjet me interes vital, pro edhe me dispozitat tjera të Kushtetutës që janë përcaktuese të identitetit kushtetues të Kosovës. Të kësaj natyre do të ishin pjesë apo dispozitat kushtetuese që flasin për moscenimin e integritetit territorial dhe sovranitetit të vendit, sundimin e ligjit dhe demokracinë, liritë dhe të drejtat e njeriut nga kapitulli dy dhe tre i Kushtetutës, si dhe çdo dispozitë tjetër që do të shkaktonte diskriminim të shtetasve të Kosovës në çfarëdo baze qoftë. Ndryshimet politike në rregullimin e brendshëm kushtetues të vendit dhe kështu me radhë nuk paraqesin ndalesa për të qenë objekt i referendumit. Kjo për shkak se Kosova mund të vendosë të jetë një monarki, një gjysmë federatë dhe federatë apo union më dikë tjetër, krejt kjo me supozim që nuk shkaktohet ndryshimi formal i kufijve të territorit të Kosovës dhe, për pasojë, cenimi i sovranitetit të saj territorial. Po ashtu, i ndaluar do të ishte edhe referendumi i bazuar në vullnetin e shumicës së njërit komunitet të Kosovës, që do të shkaktonte copëtim të një pjesë të territorit të saj dhe cedimin e tij një shteti tjetër fqinjë të Kosovës.

Pika e tretë e nenit 113.3 përcakton juridiksionin e Gjykatës sa i përket kontrollit kushtetues të aktit të shpalljes së **gjendjes së jashtëzakonshme** dhe të veprimeve të ndërmarra gjatë gjendjes së jashtëzakonshme. Sovran është ai, e thotë apogjeti i shtetit totalitar **Karl Shmit** (Carl Schmit (1888-1985) që vendos mbi gjendjen e përjashtimit.[137] Situata e jashtëzakonshme paraqet një gjendje njerëzore në të cilën individi dhe bashkësia ndeshen më një pushtet shtetëror dhe politik në tërësi të liruar nga normat juridiko-kushtetuese, përkatësisht një gjendje njerëzore kundrejt pushtetit që prezantohet si i shtrënguar (i detyruar) për të ushtruar atë pothuajse pa asnjë kontroll efektiv. Kjo gjendje njerëzore, **kur pushteti vërtetë është vetëm sovrani**, mund të shkaktohet si pasojë e faktorëve njerëzorë, siç janë luftërat, revolucionet, konfliktet e brendshme të intensitetit të lartë dhe kështu me radhë, ose e faktorëve jashtë vullnetit të njeriut, siç janë tërmetet e vërshimet, sëmundjet infektive (rasti më i njohur në botë, pandemia me virusin **CORONA** apo **Covid-19**), si dhe katastrofat e ndryshme natyrore. Kjo renditje e shkaqeve të gjendjes së jashtëzakonshme reflektohet edhe në Kushtetutën e vitit 2008.

---

136 Neni 81.1 [Legjislacioni me Interes Vital] i Kushtetutës:
"1. Për miratimin, ndryshimin ose shfuqizimin e ligjeve në vijim, kërkohet vota e shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët janë të pranishëm dhe që votojnë, si dhe të shumicës së deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë, të cilët mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë:
(1) ligjet të cilat ndryshojnë kufijtë e komunave, themelojnë ose shuajnë komuna, përkufizojnë shtrirjen e pushteteve të komunave dhe pjesëmarrjen e tyre në marrëdhëniet ndërkomunale dhe tejkufitare;
(2) ligjet të cilat zbatojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, me përjashtim të atyre të përcaktuara me Kushtetutë;
(3) ligjet për përdorimin e gjuhëve;
(4) ligjet për zgjedhjet lokale;
(5) ligjet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;
(6) ligjet për liritë fetare ose për marrëveshjet me komunitetet fetare;
(7) ligjet për arsimin;
(8) ligjet për përdorimin e simboleve, përfshirë simbolet e komuniteteve dhe për festat publike."

137 Cf. Carl Schmitt, *Political Theology. Four Chapters on the Concept of Sovereignty* (The University of Chicago Press: Chicago, 1985), kapitulli 1 ("Definition of Sovereignty"), fq. 5-15.

Në literaturë është vërejtur se instituti i gjendjes së jashtëzakonshme dhe tri shkaqet si më sipër që shkaktojnë atë, kanë për emërues të përbashkët situatën e cila vlerësohet nga kompetentët si **rrezik ekzistencial për jetën e shtetit**. Këtu, pra, bëhet fjalë për rrezikun ekzistencial për jetën e shtetit dhe me këtë parasysh janë draftuar të gjitha instrumentet ndërkombëtare,[138] përjashtim **Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut** (DUDNJ).[139] Ky fakt i bën të dallueshme derogimet (suspendimet) nga të drejtat e njeriut prej instituti i kufizimeve të lirive dhe të drejtave të njeriut. Në rastin e parë bëhet fjalë për një gjendje të jashtëzakonshme, jo normale, ku shteti fiton të drejtën për të suspenduar disa nga të drejtat e garantuara me kushtetutë nacionale si dhe që ka marrë përsipër si detyrime ndërkombëtare përmes traktateve dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare. Kjo, thënë me fjalë të tjera, përbën një suspendim të lirive dhe të drejtave të caktuara të garantuara më kushtetutë, ligje, traktate dhe instrumente të tjera ndërkombëtare. Kjo gjendje monitorohet ndërkombëtarisht, siç do të shihet në vijim, dhe është e përkohshme. Ky nuk është rasti me kufizimet e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Në rastin e **kufizimeve të lirive dhe të drejtave të njeriut** bëhet fjalë për kufizimet e vëna paraprakisht me rastin e definimit ligjor të së drejtës që kufizohet dhe që është e garantuar me kushtetutë. Një kufizim i tillë mund të bëhet edhe përmes specifikimit të situatave konkrete në të cilat vjen deri të kufizimi i të drejtave si dhe caqet e atij kufizimi. Në cilën do mënyrë, kufizimet duhet të përcaktohen më parë me ligj, që nënkupton se ato nuk guxojnë të jenë **ad hoc**, të ndërmarra në mënyrë partikulariste (të pjesshme) dhe administrative. Në rastin e kufizimit bëhet fjalë për një veprim që e ndërmerr organi përfaqësues nacional, ligjvënësi, duke respektuar **parimin e proporcionalitetit**. Definimi më i përgjithshëm i proporcionalitetit është se ai paraqet një test në tri pjesë, me të cilin kërkohet përgjigje në tri pyetje.

- a është masa që ndërmerret **e përshtatshme** për të arritur një qëllim legjitim?
- a është masa e **domosdoshme** për të arritur atë qëllim legjitim apo ekzistojnë mjete të tjera më pak kufizuese të lirive dhe të drejtave të njeriut? dhe
- masa e ndërmarrë a imponon një **barrë të tepërt** në individët e afektuar?

Këto tri pyetje të **testit të proporcionalitetit** janë të mishëruara fort qartë në dispozitat e nenit 55 të Kushtetutës, me një formulim pak më të ndryshëm,[140] të cilat në një mënyrë të dukshme dallojnë nga dispozitat e nenit 56 në vijim, që normojnë situatat e **derogimit** (suspendimit) nga të drejtat e njeriut.[141] Neni 56 përbën një autorizim për ligjvënësin për të kufizuar liritë dhe të drejtat e garantuar me Kushtetutë, por në të njëjtën kohë përmban edhe kriteret kufizuese për të njëjtin se deri ku mund të shkohet dhe

---

138 Viktor Mavi, "Limitations of and Derogations from Human Rights in International Human Rights Instruments" *Acta Juridica Hungarica* Vol. 38 No. 3-4 (1997), fq. 107-114 në fq. 110.

139 Gordon Brown (ed.), *The Universal Declaration of Human Rights in the 21st Century. A Living Document in a Changing World* (Open Book Publishers: Cambridge, UK, 2016), kapitulli "Limitations and Derogations" fq. 57-62 në fq. 59 (autori thekson se **DUDNJ** ka futur idenë e derogimeve të të drejtave të njeriut, por nuk ka krijuar asnjë standard se si dhe kur mund të bëhen ato; kjo është bërë më vonë me aktet të tjera ndërkombëtare, në rend të parë më **Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike** të viti 1966 (KNDCP).

140 Neni 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] i Kushtetutës
"1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.
2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.
3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.
4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.
5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrsesi esencën e së drejtës së garantuar."

141 Neni 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme]
1. Shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore që mbrohen me Kushtetutë, mund të bëhet vetëm pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme sipas kësaj Kushtetute dhe vetëm deri në masën sa është e domosdoshme nën rrethanat e dhëna.
2. Shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 23, 24, 25, 27, 28, 29, 31, 33, 34, 37 dhe 38, të Kushtetutës nuk është e lejuar në kurrfarë rrethanash."

si mund të bëhen kufizimet sipas këtij autorizimi. Balansimi i këtyre dy aspekteve të këtij neni me rastin e zbatimit e formon parimin e proporcionalitetit në rastet e kufizimit të lirive dhe të drejtave të njeriut.[142]

Për dy situatat, "kufizimet" (neni 55) dhe "derogimet" (neni 56), vlen të theksohet, Kushtetuta ka ndjekur formulimet dhe praktikat standarde ndërkombëtare dhe regjionale mbi kufizimin e lirive dhe të drejtave njerëzore dhe derogimin nga to. Këtë e ka konfirmuar qartë edhe **Gjykata Kushtetuese** në aktgjykimin e saj në rastin **KO 54/20**, i vetmi vendim që është marrë deri më sot lidhur me çështjen e dallimit në mes të neneve 55 dhe 56 të Kushtetutës.[143] Në këtë aktgjykim, në mënyrë të qartë është bërë analiza e **testit të proporcionalitetit** në të gjitha fazat e tij.[144] Duke e bërë të qartë se plotësimi i katër kushteve të testit të proporcionalitetit duhet të bëhet në mënyrë kumulative, ashtu siç janë të mishëruara ato në mënyrë të qartë në nenin 55 të Kushtetutës, Gjykata ka theksuar se qeveria nuk ka pasur autorizim ligjor për kufizim të përgjithshëm të lirisë së lëvizjes, të tubimit dhe të drejtës së privatësisë në tërë territorin e Kosovës. Në arsyetimin e vet, Gjykata ka theksuar se vendimi i qeverisë për situatën emergjente shëndetësore nuk mund të shërbejë si bazë kufizim të përgjithshëm të lirive dhe të drejtave të njeriut në tërë territorin e Kosovës dhe për të gjithë personat, pa marrë parasysh nëse janë infektuar apo jo.[145]

Në të njëjtin vendim, Gjykata ka bërë edhe dallimin në mes të "**kufizimit**" nga neni 55 dhe "**derogimit**" nga neni 56 i Kushtetutës. Në rastin e parë, me plot të drejtë, Gjykata ka konstatuar se bëhet fjalë për kufizime të bazuara në ligj dhe në respektim të testit të proporcionalitetit, dhe kanë natyrë më të lehtë, në ndërkohë që **derogimi** i takon kufizimeve më të rënda dhe që mund të ndodhë vetëm në situatat e gjendjes së shpallur të jashtëzakonshme, pra bëhet me vendim të individual të **Kuvendit të Kosovës**.[146] Në fakt, stricto sensu, në rastin e dytë nuk bëhet fjalë për kufizim, por për **derogim** (pezullim) të shfrytëzimit të lirive dhe të drejtave të garantuara me Kushtetutë, përveç atyre të specifikuara në nenet 23, 24, 25, 27, 28, 29, 31, 33, 34, 37 dhe 38 të Kushtetutës, të cilat nuk është e lejuar të derogohen (pezullohen) në kurrfarë rrethanash. Në rastin e parë, si aktor i autorizuar për kufizim është Kuvendi, njëjtë si në të dytin. Në rastin e parë, megjithatë, kufizimi bëhet me ligj. Në të dytin, ndërkaq, kufizimi bëhet me vendim individual të Kuvendit me të cilin ratifikohet dekreti i Presidentit për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme.

Vendimi i **Qeverisë së Kosovës** në rastin e vendosur nga Gjykata, si më sipër, ka pasur të bëj me mungesën e ligjit, kushtit të parë që duhet të plotësohet me rastin e kufizimit të lirive dhe të drejtave sipas nenit 55 të Kushtetutës. Me këtë, Gjykata ka treguar se asnjëherë liritë dhe të drejtat e garantuara me Kushtetutë nuk mund të kufizohen me vendime administrative, nëse ato vendime nuk kanë autorizim shprehimor në ligj për një gjë të tillë. Çdo masë e marrë një shoqëri demokratike, quhet e domosdoshme vetëm atëherë kur ajo ndërmerret në zbatim të parimit kushtetues mbi sundimin e ligjit, i cili përbën një kusht të domosdoshëm për përballimin e gjendjeve emergjente. E thënë më fjalë të tjera, **sundimi i ligjit** paraqet një efekt refleksiv të plotësimit të kushtit tjetër nga neni 55 i Kushtetutës, që thotë se kufizimet janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike vetëm nëse ato ndjekin rrugën e përcaktuar me ligj.[147]

---

142 "[…] 127. Gjykata vëren se, kur një ligj, si në këtë rast Ligji për Shëndetësi, i kufizon të drejtat kushtetuese, siç është këtu e drejta e garantuar me nenin 49, një kufizim i tillë është kushtetues, në qoftë se ai është proporcional. Testii proporcionalitetit është përshkruar në nenin 55 të Kushtetutës.
128. Neni 55 i Kushtetutës është i dyfishtë: ai ofron arsyetim për kufizimin e të drejtave kushtetuese, por në të njëjtën kohë ofron edhe kufijtë e kufizimit të tillë". *Rasti KO 131/12. Aktgjykim. Parashtrues: Dr. Shaip Muja dhe 11 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 18, 19,41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi, Nr. 04/L-125, të miratuar nga Kuvendi, më 13 dhjetor 2012.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 15 prill 2013. Nr. ref.: AGJ404/13. Cf. edhe paragrafët 129-175 të aktgjykimit, në të cilët Gjykata ka dhënë një shtjellim të shkëlqyer të parimit të proporcionalitetit, bazuar në analizën e nenit 55 të Kushtetutës nga aspekti krahasimor.

143 *Rasti KO 54/20. Aktgjykim. Parashtrues: Presidenti i Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 01/15 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të 23 marsit 2020.* **Gjykata Kushtetues e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 6 prill 2020. Nr. ref.: AGJ 1543/20.

144 Ibid., paragrafët. 196-199.

145 Ibid., paragrafët: 142.

146 Ibid., paragrafët 184-188; 320.

147 Ibid., paragrafi 249.

Një situatë e ngjashme që është vendosur me këtë vendim të Gjykatës që diskutojmë këtu haset në **Sllo-veni**, ku qeveria aktuale sllovene ka ndërmarrë masa shumë të ngjashme me këto të qeverisë së Kosovës. Në rastin slloven, në fakt, masat janë tërësisht të ngjashme në aspektin e rëndësisë së tyre kushtetuese: pa pasur një autorizim të ligjit për një gjë të tillë, qeveria e këtij vendi ka vendosur uzurpimin e kompetencave të ministrisë së Shëndetësisë dhe ka përfshirë në masa emergjente krejt territorin slloven dhe qytetarët e saj. Një hap i tillë është kritikuar ashpër nga konstitucionalistët sllovenë.[148]

Kjo nuk do të thotë që ligji vetëpërveti përbën një kusht të mjaftueshëm për respektimin e standardit të **sundimit të ligjit** në kushtet e luftimit të, siç është kjo me virusin **COVID-19**. Pasja e një autorizimi ligjor përbën një kusht të domosdoshëm, por jo të mjaftueshëm: për të qenë çdo gjë në rregull në aspektin kushtetues në vijim të respektimit të testit të proporcionalitetit në kuptim të gjerë, siç përcaktohet në nenit 55 të Kushtetutës dhe që përbën një standard evropian, duhen plotësuar edhe kushtet tjera veç pasjes së një autorizimi shprehimor ligjor për veprim të organit administrativ.[149] Ka pasur raste, siç është ai në **Hungari**, ku nxjerrja e ligjit në kohë të pandemisë me sëmundjen **COVID-19** ka shërbyer për të zgjeruar në mënyrë uzurpative pushtetet diktatoriale ekzekutive nga Qeveria e kryeministrit **Viktor Orban**. (Viktor Mihály Orbán, në pushtet që nga vitit 2010). Kjo sjellje është vlerësuar nga konstitucionalistët hungarezë si e ngjashme me aktin autorizues në kohën e **Gjermnaisë** së **Vajmarit**, kur një nen i Kushtetutës, neni 48, i pat mundësuar **Adolf Hitler**-it që të vijë në pushtet, duke i dhënë autorizime për të qeverisur përmes dekreteve. Sipas kritikëve, ngashëm ka vepruar parlamenti në **Hungari**, i cili në kohën e pandemisë me virusin **COVID-19** i ka dhënë autorizime diktatoriale kryeministrit **V. Orban** për të qeverisur me dekrete, deri të tejkalohet kjo gjendje në të cilën sot gjendet ky vend, njëjtë si krejt vendet tjera të **Evropës** dhe botës.[150]

Të shohim në vijim si duket kjo sa i përket gjendjes së jashtëzakonshme dhe standardeve tona kushtetuese, duke i trajtuar gjithnjë në dritën e standardeve dhe praktikave evropiane dhe ndërkombëtare.

Në një gjendje të tillë, pra në një gjendje të jashtëzakonshme, liritë dhe të drejtat e njeriut mund të derogohen (**supendohen**), duke përjashtuar liritë dhe të drejtat e natyrës absolute. Këtë e thot edhe Kushtetuta në paragrafin 2 dytë të nenit 56. Ky është standard ndërkombëtar, gjerësisht i pranuar, dhe përbën një **sine qua non** i të të gjitha vendeve që kultivojnë demokraci kushtetuese.[151] Pikërisht për këtë arsye ka rëndësi që akti i atij që është sovran, akti i shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, së bashku me veprimet e ndërmarra gjatë saj, të normohet paraprakisht me norma juridike-kushtetuese. Edhe këtu, me rastin e normimit me kushtetutë, shtetet duhet të zbatojnë **parimin e proporcianalitetit**, parim që ka status të normës juridike-ndërkombëtare me karakter universal.[152] Këtë e bën edhe Kushtetuta në paragrafin e parë të nenin 56 kur thotë se derogimi (pezullimi) duhet të bëhet "vetëm deri në masën sa është e domosdoshme nën rrethanat e dhëna". Parimi i mosdiskriminimit, vetëpërveti përbën një shtyllë të rëndë-

---

148 Jaka Kukavica, "(Rule of) Law in the Time of Covid-19: Warnings from Slovenia, VerfBlog, 2020/3/25." Në internet: https://verfassungsblog.de/rule-of-law-in-the-time-of-covid-19 warnings-from-slovenia/.(shikuar në prill 20020).

149 Ky parim ka dy kuptime, kuptimin e gjerë dhe kuptimin e ngushtë. Në kuptimin e gjerë përfshin kalimin e katër fazave të testit, që nga caktimi me ligj e deri të ruajtja e esencëss së të drejtës që kufizohet. Në kuptimin e ngushtë, ndërkaq, **parimi i proporcionalitetit** përfshin vetëm balansimin në mes të mjetit të përdorur dhe qëllimit të ndjekur, nëse këto dy elemnete janë në proporcion të drejtë për arritjen e një qëllimi legjitim (në rastin tonë luftimin e pandemisë së shkaktuar nga virusi **COVID-19**). Cf. më shumë për kuptimin, lindjen, zhvillimin dhe aplikimin e **parimit të proporcionalitetit**, në librin monumental të Ahron Barak, *Proportionality. Constitutional Rights and Their Limitation* (Cambridge University Press: Cambridge, 2012) (ku autori deri në detaje të pabesueshmë flet për këtë parim, si lindi dhe si u zhvillua dhe si ka qenë dhe si është gjendja e tij sot në sistemet kushtetuese të vendeve demokratike perëndimore; në veçanti fascinues është trajtimi i nuancave të zbatimit të parimit në sistemet e ndryshme kushtetuese dhe përshkimi që ky parim ia bënë tërë sistemit kushtetues, në veçanti pjesës që ka të bëjë me liritë dhe të drejtat e njeriut).

150 Kriszta Kovács, "Hungary's Orbánistan: A Complete Arsenal of Emergency Powers, VerfBlog, 2020/4/06". Në internet: https://verfassungsblog.de/hungarys-orbanistana-complete-arsenal-of-emergency-powers/. (shikuar në prill 2020).

151 *Jaime Oraa, Human Rights in States of Emergency in International Law* (Oxford Monog (Clarendon Press: Oxford, 1992) fq. 87-139.

152 Ibid., fq. 140-170.

sishme në gjendjet e jashtëzakonshme, ani se këtë Kushtetuta nuk e thotë në mënyrë shprehimor. Kjo, megjithatë, nënkuptohet nisur nga fakti se **parimi i mosdiskriminimit** përbën një parim të përgjithshëm që vlen për secilën normë kushtetuese, vendim apo akt tjetër juridik me rastin e zbatimit në praktikë. Në planin ndërkombëtar, konventat që normojnë liritë dhe të drejtat e njeriut dhe që janë të zbatueshme edhe në Kosovë konform nenit 22 të Kushtetutës, pa asnjë përjashtim i kushtojnë rëndësi të madhe respektimit të **parimit të mosdiskriminimit** në rastet e gjendjeve të jashtëzakonshme.[153] Kjo nënkupton që, bazuar në marrëveshjet ndërkombëtare nga neni 22 i Kushtetutës, parimi i mosdikriminimit përbën një standard që Kosova duhet ta respektoj kurdo që futet në gjendjen e jashtëzakonshme sepse, si i tillë, përbën një detyrim ndërkombëtar të marrë nga ne përmes normës kushtetuese nga nenit 22 si më sipër. Këtyre instrumenteve dhe marrëveshjeve iu kthehemi sërish në vijim, për aq sa ato kanë të bëjnë me vënien e standardeve lidhur me gjendjen e jashtëzakonshme.[154]

Ky institut ka status kushtetues për shkak se gjendjet e jashtëzakonshme, historikisht shikuar, përbëjnë një hapësirë të madhe për keqpërdorim real të pushtetit dhe cenim të të drejtave dhe lirive njerëzore.[155] Në demokracitë liberal e perëndimore, thuajse pa asnjë përjashtim, ekzistojnë dispozita kushtetuese të detajuara lidhur me gjendjen e jashtëzakonshme: **konstitucionalizmi i aktit të shpalljes të gjendjes së jashtëzakonshme, si në aspektin substancial ashtu edhe në atë procedural, si dhe monitorimi i gjendjes dhe veprimeve të kryera gjatë saj dhe më pas, përbëjnë një shenjë dalluese në mes tyre dhe vendeve autoritare ku apriori nënkuptohet se pushteti është sovran dhe nuk ka asnjë kufizim serioz juridik-kushtetues në gjendet e tilla të jashtëzakonshme.**

Dispozitat kushtetuese nëpër këto vende liberale i lejojnë pushtetit shtetëror të drejtën e derogimit (pezullimit) nga disa dispozita kushtetuese që garantojnë liritë dhe të drejtat e njeriut, gjithnjë me kusht që një gjë e tillë të jetë e kufizuar, e përkohshme dhe nën mbikëqyrje të vazhdueshme të "syrit të popullit", përkatësisht të përfaqësuesit të sovranit. Në këtë drejtim, siç do të shohim, **Kosova** nuk bën përjashtim: jo vetëm që kjo pikë e nenit 113.3 që flet për juridiksionin kushtetues në çështjet e gjendjes së jashtëzakonshme, por edhe dispozitat tjera materiale kushtetuese flasin gjerësisht me terma e standarde të vendeve të demokracive liberale kushtetuese perëndimore sa i përket gjendjes së jashtëzakonshme, që nga shpallja e deri te përfundimi i saj. Ato dispozita materiale mbi gjendjen e jashtëzakonshme gjenden në kapitullin XI që flet për sektorin e sigurisë. Aty, në vetëm një nen, në nenin e fundit 131 të Kushtetutës së vitit 2008, përcaktohen deri në detaje rregullat dhe institucionet që vendosin për gjendjen e jashtëzakonshme, kushtet për mbajtjen e saj në fuqi dhe llojin e veprimeve të ndërmarra. Mbi të gjitha, në fillim aty jepen tri shkaqe për vënien e gjendjes së jashtëzakonshme: dy nga to janë të natyrës së shkaqeve njerëzore, kurse një i takon shkaqeve që vinë nga natyra dhe jashtë kontrollit të njeriut.[156] Ky nen bën pjesë ndër nenet më të gjata të Kushtetutës së vitit 2008. Në fakt, ky **është neni më i gjatë i saj. Kjo është kështu sepse ky nen normon shkaqet, procedurat dhe veprimet e organeve shtetërore në lidhje me gjendjen e jashtëzakonshme, diçka që mund të ndodhë papritur. Këto dispozita, pra, nuk kanë të bëjnë me definimin dhe kompetencat e një organi apo institucioni konkret kushtetues, por me përshkrimin e rrethanave potencialisht faktike lidhur me gjendjen e jashtëzakonshme.**

Para se të diskutojmë zgjidhjet kushtetuese kosovare, vlen të theksojmë këtu se nuk është vetëm e drejta e brendshme ajo që ka treguar një interes për rregullimin juridik të situatave të gjendjes së jashtëzakonshme. Kjo ka shumë rëndësi në rastin tonë nisur nga fakti se në nenin 22 të Kushtetutës kemi një listë të mar-

---

153 Ibid., fq.171-189.

154 Cf. fusnota 157, **infra**, dhe testi që e shoqëron, në këtë seksion.

155 Cf. Giorgio Agamben, "A Brief History of the State of Exception: An excerpt from *State of Exception*". Në internet: http://www.press.uchicago.edu/Misc/Chicago/009254.html (shikuar në shkurt 2018).

156 Neni 131 [Gjendja e Jashtëzakonshme] i Kushtetutës:
"1. Presidenti i Republikës mund të shpallë Gjendjen e Jashtëzakonshme, kur:
(1) ka nevojë për masa emergjente të mbrojtjes;
(2) ka rrezik të brendshëm ndaj rendit kushtetues ose sigurisë publike;
(3) ka fatkeqësi natyrore, e cila prek tërë territorin e Republikës së Kosovës ose një pjesë të tij […]"

rëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare që kanë status të normave kushtetuese dhe kanë zbatim të drejtpërdrejtë në sistemin e brendshëm juridik, për aq sa ato përmbajnë norma të vetekzekutueshme.[157] Të nisim me **KDNCP**.

Sikundër u tha më sipër, **DUDNJ** nuk ka normuar situatat e gjendjes së jashtëzakonshme. Kjo është bërë për herë të parë me **KNDCP**: neni 4 i saj lejon suspendimin e të drejtave të garantuara me të në rastet e emergjencave publike, që është një referim për gjendjen e jashtëzakonshme. Suspendimi në fjalë, megjithatë, ka disa kufizime:

- e para, ai duhet të të bëhet vetëm në kufijtë e kërkuar për ta sjellë situatën nën kontroll;
- e dyta, të drejtat absolute (p.sh. e drejta për jetë, ndalimi i torturës, skllavëria, kufizimi i lirisë për marrje të dhunshme të borxhit, respektimi i **nullum crimen sine lege** dhe **nulla pene sine lege,** njohja dhe respektimi i personalitetit para ligjit, liria e mendimit, fesë dhe ndërgjegjes) nuk mund të suspendohen; dhe
- e treta, gjendja e tillë duhet që të lajmërohet tek Sekretari Gjeneral i **OKB**-së.[158]

Stipulim të ngjashëm ka edhe **KEDNJ** në nenin e saj 15 ["Suspendimet gjatë Emergjencave"]. Në bazë të këtij neni vihen disa kushte **substanciale** dhe disa tjera të natyrës **procedurale** që shtetet duhet t'i marrin parasysh dhe respektojnë me rastin e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme dhe gjatë kohës sa zgjatë ajo. Në kushtet **substanciale** bëjnë pjesë. e **para**, suspendimi i të drejtave dhe lirive njerëzore mund të kryhet vetëm në kohën e gjendjes së luftës apo gjendjes tjetër të jashtëzakonshme që rrezikon jetën e shtetit;[159] e **dyta**, shteti mund të shmangë (suspendojë) detyrimet dhe të marrë masa të caktuara shmangieje nga detyrimet kontraktuale sipas **KEDNJ** vetëm deri në masën që kërkohet nga situata e tillë;[160] dhe, e **treta**, suspendimet e lirive dhe të drejtave të njeriut nuk guxojnë të jenë në kundërshtim me detyrimet tjera të shtetit sipas të drejtës ndërkombëtare.[161] Në kushtet **procedurale**, ndërkaq, bëjnë pjesë ato kushte që shteti duhet t'i respektojë në secilën situatë të gjendjes së jashtëzakonshme: sipas nenit 15 paragrafi 3 të **KEDNJ**, shteti që shfrytëzon të drejtën e suspendimit (derogimit) nga liritë dhe të drejtat e garantuara detyrohet që të njoftoj Sekretarin e Përgjithshëm të **KE**-së. Një njoftim i tillë duhet të specifikojë masat e ndërmarra, arsyet për marrjen e tyre dhe datën kur masat e tilla pushojnë së vepruari.[162]

Siç u tha, në Kosovë, dispozitat e **KNDCP** dhe të **KEDNJ** kanë status të normave kushtetuese dhe zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga të gjithë. Dispozitat e këtyre dy instrumenteve ndërkombëtare si më sipër, së bashku me nenin 131 të Kushtetutës, përcaktojnë juridiksionin material të Gjykatës sa i përket kontrollit të

---

157 Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] i Kushtetutës:
Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:
(1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
(2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
(3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
(6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
(7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
(8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese."

158 Cf. neni 4 i **KNDCP**. "International Covenant on Civil and Political Rights. Adopted by the General Assembly of the United Nations on 19 December 1966". *United Nations. Treaty Series*, vol. 999 p. 171 and vol. 1057, p. 407. Në internet. https://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=IV-4&chapter= 4 & lang=en (shikuar në janar 2018); Për shtjellime të detajuara doktrinare të raportit në mes të gjendjes së jashtëzakonshme dhe të drejtave të njeriut, si dhe të rasteve e modeleve të kufizimeve të këtyre të fundit në gjendjet e tilla, Cf. Giorgio Agamben, *State of Exception.* (University of Chicago Press.: Chicago, 2005) ; Gad Barzilai, *Wars, Internal Conflicts, and Political Order* (State University of New York Press: New York, 1996) .

159 European Court of Human Rights, *Derogation in time of emergency. Factsheet* (Press Unit: Strasbourg, 2017) fq. 2-5.

160 Ibid. fq. 5-8.

161 Ibid. fq. 8-9.

162 Ibid. fq. 9-14.

kushtetutshmërisë së gjendjes së jashtëzakonshme. Ai juridiksion në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme, **grosso modo**, përfshijnë kontrollin kushtetues të aktit të parë mbi vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme dhe të të gjitha veprimeve që ndërmerren gjatë saj me qëllim të ratifikimit nga organi mbikëqyrës i gjendjes së jashtëzakonshme. Në këtë futet edhe detyrimi i Kosovës për të njoftuar sekretarët e **OKB**-së dhe **KE**-së mbi shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, masat e ndërmarra dhe bazën juridike dhe, në veçanti, kohën sa do të zgjasë ajo. Kjo ka rëndësi të thuhet sepse ne jemi shtet sovran dhe i pavarur dhe ky detyrim buron sipas të **drejtës ndërkombëtare zakonore**, që obligon të gjitha shtetet anëtare të bashkësisë ndërkombëtare. Me këtë Kosova përmbush një detyrim ndërkombëtar ngaqë mund të ndodhë që shtetet tjera të kenë nevojë për të marr masa të caktuara që ndërlidhen me gjendjen e jashtëzakonshme që shpallet në vendin tonë (mbrojta e shtetasve të tyre dhe pronave, marrjen e masave për luftimin e të keqes së përbashkët dhe kështu me radhë).

Sa i përket aktit me të cilën shpallet gjendja e jashtëzakonshme, Gjykata kontrollon nëse ekziston situata e atillë që mund të subsumohet (nënvihet) nën kuptimin e gjendjes së vërtetë të jashtëzakonshme. Me fjalë të tjera, këtu Gjykata vendos nëse janë plotësuar kushtet për shpalljen e gjendjes së tillë. Situatat e krijuara që shërbejnë si shkak për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, sikundër u tha, mund të jenë të **natyrës njerëzore** (lufta, konflikti i madh civil, çrregullimet e rënda në vend etj.) apo të natyrës **ekstra-njerëzore** (tërmetet, sëmundjet epidemike të natyrës katastrofale, shkaqet industriale etj.). Këto situata që krijohen dhe shërbejnë si shkak për futjen e gjendjes së jashtëzakonshme, ekzistojnë të përcaktuara me Kushtetutës,[163] kurse me ligj të veçantë duhet të normohet sjellja e organeve të shtetit gjatë gjendjes së jashtëzakonshme[164] si dhe modalitetet e kompensimeve të dëmit që u shkaktohet qytetarëve, jetës dhe pronës së tyre.[165]

Situatat që shërbejnë si shkak për kërkesën për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme duhet të shënohen në aktin e shpalljes - dekretin e Presidentit të Republikës. Është Presidenti i Republikës, jo Kuvendi i Kosovës, ai që shpallë menjëherë një dekret, i cili përcakton natyrën e gjendjes së emergjencës apo të rrezikut dhe çfarëdo kufizimi mbi të drejtat dhe liritë.[166] Organi përfaqësues, ndërkaq, flet në emër të sovranit, duke pasur fjalën e fundit për dekretin e propozuar nga Presidenti: ai vendos në një afat prej dyzetë e tetë (48) orëve nëse do të pranojë dekretin e propozuar ose ta refuzojë atë.[167]

Në kryerjen e kontrollit kushtetues të aktit mbi shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, Gjykata shërben si një mekanizëm i kontrollimit të **ekzistimit të shkaqeve** për shfrytëzim të kompetencës për vendosje të gjendjes së jashtëzakonshme, nëse janë respektuar **procedurat për shpalljen** e saj, **caqet kohore të aktit mbi shpalljen** dhe çdo gjë tjetër që ka të bëjë me respektimin e Kushtetutës gjatë gjendjes së jashtëzakonshme.

Nuk do mend që shkaqet mund të ekzistojnë dhe të jenë të dukshme.[168] Akti për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, megjithatë, duhet të provojë (dëshmojë), bazuar në vlerësimet e organeve kompetente,

---

163 Neni 131.1 [Gjendja e Jashtëzakonshme] i Kushtetutës:
"1. Presidenti i Republikës mund të shpallë Gjendjen e Jashtëzakonshme, kur: (1) ka nevojë për masa emergjente të mbrojtjes; (2) ka rrezik të brendshëm ndaj rendit kushtetues ose sigurisë publike; (3) ka fatkeqësi natyrore, e cila prek tërë territorin e Republikës së Kosovës ose një pjesë të tij […]".

164 Neni 131.2 [Gjendja e Jashtëzakonshme] i Kushtetutës:
"[...] Parimet e tjera për veprimet e institucioneve publike gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme rregullohen me ligj, por ato nuk duhet të jenë në shpërputhje me këtë nen."

165 Neni 131 [Gjendja e Jashtëzakonshme] i Kushtetutës:
"9. Ligji përcakton parimet, lëmin dhe mënyrën e kompensimit të dëmeve të shkaktuara si pasojë e kufizimeve të vendosura gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme […]".

166 Kushtetuta në paragafët 3, 4 dhe 6 të nenit 131 kërkon nga Presidenti i Republikës që në dekretin e vet të caktojë shkallën e rrezikut apo natyrën e gjendjes emergjente si dhe kufizimet e lirive dhe të drejtave të njeriut. Nga kjo shihet se dekreti duhet të jetë i arsyetuar mirë dhe të provojë përtej çdo dyshimi se fjala është për një rrezik real i natyrës eksietnciale për jetën e shtetit dhe të qytetarëve të saj, jo një situatë krize apo gjendje emergjente e natyrës së zakonshme.

167 Neni 131 parag. 3-4 ["Gjendja e Jashtëzakonshme"] i Kushtetutës

168 Neni 131.1 ["Gjendja e Jashtëzakonshme"] i Kushtetutës: "1. Presidenti i Republikës mund të shpallë Gjendjen e Jashtëzakonshme, kur: (1) ka nevojë për masa emergjente të mbrojtjes; (2) ka rrezik të brendshëm ndaj rendit kushtetues ose sigurisë publike; (3) ka fatkeqësi natyrore, e cila prek tërë territorin e Republikës së Kosovës ose një pjesë të tij […]."

nëse shpallja e gjendjes është nevojë e domosdoshme e shtetit si dhe caqet e derogimeve (shmangieve) nga liritë dhe të drejtat e njeriut të garantuara me Kushtetutë.[169] Përveç kësaj, shumica që kërkohet për miratimin e propozim-dekretit të Presidentit, ndryshon në vartësi të shkakut për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme. Kur ai shkak ka të bëjë me rrezikun nga jashtë, kjo shumicë është relativisht i lartë, dy të tretat (2/3) e atyre që janë prezent dhe votojnë. Mund të merret me mend që në një situatë të rrezikut nga jashtë do të jenë prezentë shumica e deputetëve ashtu që kjo shumicë e kualifikuar efektivisht mund të jetë në raport me numrin e tërësishëm të deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Nuk përjashtohet mundësia që shumica e kualifikuar të shikohet kundrejt numrit të tërësishëm të deputetëve jo serbë, nisur nga fakti se serbët mund të kenë pikëpamje të të ndryshme rreth shkaqeve të gjendjes së jashtëzakonshme që kanë të bëjnë me rrezikun e jashtëm.

Në rastet e shkaqeve që kanë të bëjnë me faktorë natyrorë, kjo shumicë nuk është aq e lartë, përkatësisht është një shumicë e thjeshtë e atyre që janë prezentë dhe votojnë. Kjo sepse supozohet që deputetët do të kenë solidaritet të madh në përballimin e fatkeqësive dhe situatave që vijnë nga natyra. Kjo logjikë nganjëherë tradhton, siç dëshmohet nga situata në të cilën gjendemi në kohën shkrimit të këtyre rreshtave, 5 prill 2020: Kosova gjendet në mesin e pandemisë **COVID – 2019,** kurse në skenën politike ka përçarje më shumë se çdoherë në të kaluarën. Qeveria **Albin Kurti** ka rënë me mocion votëbesimi më datën 25 mars dhe ka ngelur në detyrë që atëherë, kurse **Gjykata Kushtetuese** ka vendosur se vendimi i Qeverisë për izolim dhe kufizim të lirive dhe të drejtave të njeriut është jo kushtetues. Qeveria **Kurti** refuzoi para tri javësh futjen e gjendjes së jashtëzakonshme, nga frika e përmbysjes së pushtetit. Asnjë pajtim nuk ekziston në mes të forcave politike për mënyrën e përballimit të gjendjes.

Së fundi, shkaqet që kanë të bëjnë me rrezikun e brendshëm ndaj rendit kushtetutës, pra çështjet që lidhen me sigurinë e brendshme të vendit, po ashtu kërkojnë një shumicë të votave të të gjithë deputetëve që janë prezentë dhe votojnë. Procedura dhe gjërat tjera rreth shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme për këtë shkak janë të njëjta me ato që lidhen me fatkeqësitë natyrore apo të shkaktuara nga faktorët industrialë.

Sa i përket aspektit të **procedurave të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme**, Gjykata kontrollon veprimet e ndërmarra prej momentit të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme e deri në përfundim të saj. Kjo nënkupton që ajo kontrollon arsyeshmërinë dhe proporcionalitetin e masave të ndërmarra gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, nevojën për suspendimin e të drejtave të njeriut, gjykon nëse ndonjë nga të drejtat absolute të njeriut janë shkelur gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, si dhe nëse është tejkaluar arsyeja për të vazhduar gjendja e tillë.[170] Në situatat e gjendjes së jashtëzakonshme rëndësi të posaçme kanë liritë dhe të drejtat e njeriut të natyrës **absolute**, meqenëse ato që kanë natyrë relative, mund të

---

[169] Në paragrafët 3 dhe 4 të nenit 131 përcaktohet qartë se dekreti i Presidentit mbi shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme duhet të japë arsyet e shpallje dhe caqet e kufizimeve të lirive dhe të drejtave njerëzore dhe çdo gjë tjetër që lidhet me gjendjen e jashtëzakonshme. Si arsye për shpalljen e gjendje së jashtëzakonshme janë vetëm ato që janë thënë në paragrafin e parë të nenit 131. Edhe dekreti i Presidentit i nënshtrohet kontrollit politik nga ana e Kuvendit të Kosovës në një afat brenda dyzetë e tetë (48) orësh. Nëse Kuvendi nuk jep pëlqim, atëherë dekreti i Presidentit nuk ka forcë as efekt.

[170] "[...] 2. Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk suspendohet. Kufizimet mbi të drejtat dhe liritë e garantuara me këtë Kushtetutë, bëhen vetëm deri në shkallën e nevojshme, për sa më pak kohë që të jetë e nevojshme dhe në përputhje të plotë me këtë Kushtetutë. Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, ligji për zgjedhjet e Kuvendit dhe të Komunave nuk mund të ndryshohet. Parimet e tjera për veprimet e institucioneve publike gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme rregullohen me ligj, por ato nuk duhet të jenë në shpërputhje me këtë nen […]".
Formulimi si më sipër ka rëndësi sepse përbën një standard ndërkombëtar: kushtetuta dhe parimet e përfaqësimit demokratik nuk mund të ndryshohet apo suspendohem sepse një gjë e tillë i hap rrugë abuzimit dhe arbitraritetit të pafund. Këtë e ka konstatuar **Komisioni i Venecias** në rastin e dekreteve të Presidentit të Republikës së Turqisë **Rexhep Taip Erdogan**, përmes të cilëve ai ka bërë shkarkimin e kryetarëve të komunave, duke i zëvendësuar ata me lojalët të vet, në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme që ekziston atje që nga korriku i vitit 2016. Kjo nuk përbën standard sepse nuk mund të prishen organet lokale të zgjedhura përmes votës së lirë. Cf. Euroepan Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Turkey. Opinion on the Provisions of the Emergency Decree Law n° 674 of 1 September 2016 which Concern the Exercise of Local Democracy in Turkey*. Adopted by the Venice Commission at its 112th Plenary Session (Venice, 6-7 October 2017). Strasbourg, 9 October 2017. Opinion No. 888 / 2017. CDL-AD(2017)021 Or.Eng. Në veçanti paragrafet 80-92 dhe përfundimet e opinionin (paragarfet 93-101).Në internet:http://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdffile =CDL-AD (2017)021-e (shikuar në janar 2018).

derogohen (**suspendohen**).[171] Këtë fakt e vlerëson Gjykata, pra nëse ka pasur cenim të lirive dhe të drejtave të natyrës absolute, jo edhe të atyre relative, derogimi i të cilave merret i mirëqenë në situata e gjendjes së jashtëzakonshme. Ky funksion është vital sa i përket nevojës për të siguruar që gjendja e jashtëzakonshme nuk keqpërdoret nga institucionet ekzekutive në dëm të të drejtave dhe lirive të njeriut si dhe në dëm të formës dhe caqeve përmbajtjesore kushtetuese për ushtrim të pushtetit shtetëror, duke kontrolluar vazhdimisht nëse masat e ndërmarra janë në linjë me parimin e proporcionalitetit.

Në kuadër të kontrollit të kushtetutshmërisë së veprimeve të ndërmarra gjatë gjendjes së jashtëzakonshme hyn edhe **kohëzgjatja** e saj: organi përfaqësues i sovranit, parlamenti nacional, kujdeset që gjatë mbikëqyrjes së gjendjes së jashtëzakonshme mos të lejohet që gjendja e jashtëzakonshme të shndërrohet në gjendje permanente, përkatësisht të degjenerojë në një **diktaturë**. Kufizimi kohor i gjendjes së jashtëzakonshme përbën një ndër standardet kushtetuese të botës perëndimore të demokracive liberale kushtetuese. **Kosova** nuk bën përjashtim në këtë aspekt.[172]
Edhe këtu, në dy aspektet, si në aktin ashtu edhe sa i përket veprimeve të ndërmarra gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, **parimi i proporcionalitetit** del si definues i kushtetutshmërisë së aktit mbi shpalljen dhe i veprimeve të ndërmarra gjatë gjendjes së jashtëzakonshme nga ana e autoriteteve publike. Sikundër u tha më lart, ky parim përbën një detyrim ndërkombëtar të Kosovës dhe nënkupton që masat e ndërmarra të derogimit duhet të merren për aq sa një gjë e tillë është e nevojshme në situatën e dhënë konkrete. Kjo nënkupton se tërë arsenali shtetëror vihet në shërbim të tejkalimit të gjendjes dhe rikthimit në normalitet demokratik, duke mos lejuar që gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme të ndryshojë dhunshëm rendi kushtetues demokratik dhe ligjor. Për këtë arsye, në disa vende shprehimisht thuhet se nuk mund të vijë deri të ndryshimi i kushtetutës dhe i sistemeve zgjedhore dhe marrëdhënieve me zgjedhësin. Në këtë kuptim, në **Kosovë** Kushtetuta thotë se nuk mund të vijë deri te **suspendimi** i Kushtetutës dhe nuk mund të bëhen ndryshime në raportin e forcave që buron nga vota e lirë, as në nivel qendror e as në atë lokal.[173] Mosndryshimi i rendit demokratik të krijuar me kushtetutë nacionale përbën vijën e kuqe që nuk mund ta tejkalojnë autoritetet publike gjatë kohës së zgjatë gjendja e jashtëzakonshme. Këtij qëllimi duhet t'i shërbejë edhe juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese për kontrollin e kushtetutshmërisë

---

171 Liri dhe të drejta të **natyrës absolute**, që nuk mund të derogohen (suspendohen) në situatat e gjendjes së jashtëzakonshme dhe në kurrfarë rrethanash, sipas nenit 56.2 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme] të Kushtetutës janë si vijon: neni 23 [Dinjiteti i Njeriut], neni 24 [Barazia para Ligjit], 25 [E Drejta për Jetën], 27 [Ndalimi Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues], 28 [Ndalimi i Skllavërisë dhe i Punës së Detyruar], 29 [E Drejta e Sigurisë dhe Lirisë], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale], 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër], 37 [E Drejta e Martesës dhe Familjes] dhe neni 38 [Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë].

172 Neni 131. 5 & 6 ["Gjendja e Jashtëzakonshme"] i Kushtetutës.
" […] 5. Gjendja e Jashtëzakonshme zgjat për aq kohë sa vazhdon të kërcënojë rreziku dhe nuk mund të zgjasë më shumë se për një periudhë prej gjashtëdhjetë (60) ditësh. Me pëlqimin e shumicës së deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë, Gjendja e Jashtëzakonshme, nëse është e nevojshme, mund të zgjatet për periudha pasuese prej tridhjetë (30) ditësh, por jo më shumë se për nëntëdhjetë (90) ditë shtesë gjithsej.
6. Kuvendi mund të vendosë kufizime të tilla, sipas nevojës, për sa i përket kohëzgjatjes dhe shkallës së Gjendjes së Jashtëzakonshme. Kur Presidenti konstaton se rreziku ndaj Republikës së Kosovës është i natyrës së jashtëzakonshme, Kuvendi mund të vendosë që Gjendja e Jashtëzakonshme të zgjasë më shumë se njëqind e pesëdhjetë (150) ditë, vetëm nëse për të votojnë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit […]. "

173 Neni 131. 2 [Gjendja e Jashtëzakonshme"] i Kushtetutës.
"2. Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk suspendohet. Kufizimet mbi të drejtat dhe liritë e garantuara me këtë Kushtetutë, bëhen vetëm deri në shkallën e nevojshme, për sa më pak kohë që të jetë e nevojshme dhe në përputhje të plotë me këtë Kushtetutë. Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, ligji për zgjedhjet e Kuvendit dhe të Komunave nuk mund të ndryshohet […]".
Në praktikën e **GJEDNJ**, shih më shumë edhe rastin e parë kundër shtetit që ka pasur të bëjë me interpretimin e të drejtës ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, rasti **Lawless v. Ireland: 1957-1961** (no. 3), judgment of 1 July 1961, [law part] § 22:
"[...] Qeveria e secilës palë kontraktuese ka të drejtë që në rast lufte apo situate të jashtëzakonshme që rrezikon jetën e shtetit të ndërmarrë masa me të cilat suspendon detyrimet e saj ndaj Konventës përveç atyre të numëruara në nenin 15, paragrafi i dytë, me kusht që masat në fjalë të jenë të kufizuara ekskluzivisht në nevojat e situatës dhe nuk binë ndesh me detyrimet tjera nga e drejta ndërkombëtare." ***Lawless v Ireland*** (No 3), ***Lawless v Ireland***, Judgment on Merits, App no 332/57 (A/3), [1961] ECHR 2, (1961) 1 EHRR 15, IHRL 1 (ECHR 1961), 1st July 1961, ECtHR.

së të gjitha aspekteve të gjendje së jashtëzakonshme, që nga dita e shpalljes e deri në përfundim të saj. Gjykata merr vendime përfundimtare, të cilat janë efektive, që nënkupton se mund t'i shpallë kundërkushtetuese dhe t'i përjashtojë nga rendi juridik veprimet që janë ndërmarrë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, përfshirë vetë aktin e shpalljes së gjendjes së tillë. Në ushtrimin e këtij juridiksioni, Gjykata vishet me detyrën e garantimit që gjendja e jashtëzakonshme të mos keqpërdoret nga pushteti ekzekutiv, duke u bërë institucioni i vetëm i autorizuar nga kushtetuta për të kontrolluar kushtetutshmërinë e gjendjes dhe masave të ndërmarra në të. Këtë detyrë Gjykata duhet ta ushtrojë shumë shpejt: sipas nenit 35 ["Afati"] të **Ligjin nr. 03/L-121** ai afat është shumë i shkurtër, vetëm njëzet e katër (24) orë nga momenti i dekretimit të gjendjes së jashtëzakonshme nga Presidenti i Republikës.

Pika e katërt e nenit 113.3 përcakton juridiksionin e Gjykatës për të kontrolluar përputhshmërinë e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara sipas kësaj Kushtetute, dhe rishikimin e procedurës së ndjekur. Ky kontroll, siç e përmendëm në fund të kapitullit pararëndës në kontekst të **Gjykatës Speciale**, njihet me emrin **kontrolli i konvencionalitetit** dhe është mjaft i përhapur në vendet e modelit **evropian/kelsenian.** Kjo pikë e ndërton detyrimin pozitiv për Gjykatën që të kontrollojë përputhshmërinë e amendamenteve kushtetuese me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare të lidhura nga Kosova. Në një interpretim teleologjik dhe në lidhmëri me dispozitat tjera kushtetuese del se kjo dispozitë imponon detyrimin që amandamentet kushtetuese nuk guxojnë të prishin detyrimet ndërkombëtare të Kosovës, të marra sipas të drejtës ndërkombëtare, jo vetëm ato kontraktuese. Kjo bëhet e qartë në nenin 19.1 ["Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare"] të Kushtetutës, ku përcaktohet se edhe detyrimet jashtëkontraktuese të Kosovës sipas të drejtës ndërkombëtare kanë përparësi ndaj ligjit nacional. Ky juridiksion është në përputhje me nenin 56 ["Dispozitat e të Drejtës së Brendshme lidhur me Kompetencën për të lidhur Marrëveshje"] të **Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve** (KVDT), i cili përcakton që shtetet nuk mund të shfrytëzojnë mjetet e brendshme juridike për t'i anuluar detyrimet e tyre ndërkombëtare.[174] Kjo në fakt është edhe në përputhje me kërkesat e **Komisionit të Venecias** sa i përket mekanizmave të së drejtës së brendshme që duhet ta ndalojnë zhvlerësimin e detyrimeve të marra sipas së drejtës ndërkombëtare.[175] Në këtë kuptim, Gjykata vendoset në pozitën e mekanizmit që kontrollon përgjegjësinë ndërkombëtare të **Shtetit të Kosovës** sa i përket marrëveshjeve të nënshkruara ndërkombëtare, por edhe të detyrimeve tjera jashtëkontraktuale të **Kosovës** sipas të drejtës ndërkombëtare, duke u bërë kësisoj një mekanizëm shtetëror që garanton nga brenda përgjegjësinë e Kosovës ndaj së drejtës ndërkombëtare dhe aplikimit **bona fide** të detyrimeve ndërkombëtare.[176] Kjo dispozitë në **Kushtetutën e Kosovës** që barazon detyrimet kontraktuale me ato jashtëkontraktuale të së drejtës ndërkombëtare, paraqet pjesë të nje trendi pozitiv është të nisur pas Luftës së Ftohtë, kur demokracisë e reja, ish vendet komuniste të Evropës, u hapën ndaj pranimit të së drejtës ndërkombëtare si pjesë të rendeve të reja kushtetuese[177].

---

174 "Vienna Convention on the Law of Treaties" 1155 *U.N.T.S.* 331, 8 *I.L.M*. 679, entered into force 27 January 1980, Art. 46. Në internet; http://untreaty.un.org/ilc/texts/instruments/ english/conventions/1_1_1969 (shikuar në janar 2018)

175 Për një analizë gjithëpërfshirëse të kësaj materje nga ana e **Komisionit të Venecias**, i cili këtë qasje e ngritë në rang të standardit evropian, cf. më shumë në European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), "The Competence of the Constitutional Court to Control the Conformity of Laws with International Treaties: New Trends in Constitutional Justice" *CDL-JU(2009)036* English only (Strasbourg, 17 November 2009); dhe European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), "Comments on the Draft Law on the Constitutional Court of the Republic of Serbia*". Opinion no. 445/2007*, *CDL-AD* (2007) 039. Original: English (Strasbourg: 7 November 2007); Cf. gjithashtu edhe Dren Doli & Fisnik Korenica, "Kosovar Constitutional Court's Jurisdiction: Searching for Strengths and Weaknesses", fq. 824-826.

176 Në këtë drejtim mund të thuhet se ky është një standard i fuqishëm evropian. Cf. European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), "The Competence of the Constitutional Court to Control the Conformity of Laws with International Treaties. New Trends in Constitutional Justice", fq. 2.; cf. Po ashtu edhe në Marta Cartabia, "The Italian Constitutional Court and the Relationship betëeen the Italian Legal System and the European Community". *Michigan Journal of International Law*. Vol. 12 Issue 1 (Fall 1990), fq. 173-192 (ku autorja flet për rolin e **Gjykatës Kushtetuese të Italisë** sa i përket detyrimeve që rrjedhin nga traktatet e **BE**-së).

177 European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), "The Competence of the Constitutional Court to Control the Conformity of Laws with International Treaties. New Trends in Constitutional Justice" .

Përveç si një juridiksion i specializuar për Gjykatën, ky paragraf, përmes një obligimi pozitiv që e vendos mbi Gjykatën, bën që realisht të sendërtoj një raport shumë **monist** të së drejtës së brendshme me të drejtën ndërkombëtare, me kuptim epërsinë e kësaj të fundit. Kjo vërtetohet nga dispozita e nenit 36 ["Efekti Suspensiv"] të **Ligjin nr. 03/L-121**, sipas të cilës ngritja e kërkesës nga palët e autorizuara ka për pasojë pezullimin e votimit për draft-amendamentin kushtetues. Ai mund të miratohet në Kuvend vetëm pas vendimit të Gjykatës dhe duke marrë në tërësi parasysh të gjeturat e saj të dhëna në verdiktin lidhur me kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Kjo ka për qëllim që të zbusë pasojat eventuale që një amendament mund ti shkaktoj në planin ndërkombëtar, d.m.th. në aspektin e detyrimeve të Kosovës sipas të drejtës ndërkombëtare kontraktuale dhe jokontraktuale. Në jurisprudencën komparative ekzistojnë raste kur një gjykatë kushtetuese ka vendosur që asnjë detyrim ndërkombëtar nuk shfuqizohet në rastet kur ajo konstaton jokushtetutshmëri të plotë apo të pjesshme të një marrëveshjeje ndërkombëtare të ratifikuar nga parlamenti nacional.[178]

Detyrimi që e drejta e brendshme të qëndrojë në linjë me detyrimet e marra ndërkombëtare projekton një lloj hierarkie ku e drejta e brendshme, duke përfshirë të drejtën kushtetuese, qëndrojnë të varura për të drejtën ndërkombëtare (një version **kelsenian** i raportit në mes të së drejtës ndërkombëtare dhe asaj të brendshme, i cili nuk sheh nevojë për kundërvënie sepse e drejta ndërkombëtare është vazhdim i të drejtës së brendshme që bazohet në normën themelore apo në **grundnorm**).[179] Në anën tjetër, ky juridiksion i specializuar mundëson që Gjykata përveç që të ketë nën kontroll kushtetutshmërinë e amendamenteve kushtetuese sa i përket përputhshmërisë së tyre me kapitullin II të Kushtetutës, gjithashtu të kontrollojë përputhshmërinë e tyre me të traktatet ndërkombëtare të marra përsipër nga **Kosova** si dhe me të drejtën e detyrueshme ndërkombëtare. Në këtë mënyrë, juridiksioni për kontrollimin e kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese zgjerohet shumëfish, dhe e drejta ndërkombëtare (kontraktuale dhe zakonore) bëhet baza e dytë mbi të cilën gjykohet kushtetutshmëria e amendamenteve kushtetuese[180]. Kjo kompetencë duhet të dallohet nga **kontrolli kushtetues i marrëveshjeve ndërkombëtare**, për të çka do të flasim më vonë, i cili zakonisht është preventiv, siç është rasti me **Shqipërinë** dhe disa vende, por mund të jetë edhe represiv, siç është rasti me **Serbinë** dhe disa vende të tjera.[181]

Në kryerjen e këtij juridiksioni, Gjykata realisht nuk kontrollon kushtetutshmërinë në kuptimin klasik, por shndërrohet në një mekanizëm që kontrollon ligjshmërinë dhe legjitimitetin ndërkombëtar të amendamenteve kushtetuese. Në këtë kuptim, Gjykata vihet në pozitën e një organi gjysmë ndërkombëtar sepse mbron dispozitat e **KVDT** dhe, përmes saj, rendin juridik-kushtetues ndërkombëtar. Kjo është kështu sepse, përmes vënies në jetë të këtij detyrimi kushtetues, partnerët ndërkombëtarë të **Kosovës** sigurohen se detyrimet e saj sipas të drejtës ndërkombëtare mbisundojnë kundrejt detyrimeve të brendshme

---

178 "[…] 4. Vendimi i Gjykates Kushtetuese që konstaton jokushtetutshmërinë, nuk ka efekt në detyrimin ndërkombëtar të **Republikës së Hungarisë**.
5. Për shkak të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, ligjvënësi ka për detyrë që, në rastet kur është e demosdoshme që të bëhet amendamentimi i Kushtetutën, një gjë e tillë të bëhet duke krijuar në pajtueshmëri në mes të detyrimeve sipas të drejtës ndërkombëtare me detyrimeve sipas të drjetës së brendshme […]". **Constitutional Court of Hungary**. *Decision No. 4/1997 (I.22.) AB*. Date of Decision: Budapest, 21/01/1997. Në internet: http://public.mkab.hu/ dev/dontesek.nsf/0/095997541 D2A23C-8C1257ADA0052AEA 4? OpenDocument (shikuar në janar 2018).

179 Lars Vinx, *The Guardian of the Constitution. Hans Kelsen and Carl Schmitt on the Limits of Constitutional Law* (Cambridge University Press: Cambridge2015) fq. 27-35.

180 Allan R. Breëer - Carias, *Constitutional Courts as Positive Legisaltor*, fq. 20-28 (ku autori jep dallimin e thukët në mes të kontrollit të kushtetuetshmërisë dhe kontrollit të konvencionalitetit, duke u bazuar në parametrat që shërbejnë si pikë referimi për kontroll: në rastin e parë, parametër apo normë kontrolluese është norma kushtetuese, kurse në të dytin parametër apo normë që komandon kontrollin është një normë e një konvente apo marrëveshjeje ndërkombëtare).

181 I tillë ka qenë rasti me deklarimin jokushtetues të marrëveshjes për kufijtë detarë në mes të Shqipërisë dhe Greqisë Cf. "Gjykata Kushtetuese rrëzon Marrëveshjen për kufijtë detarë me Greqinë". *Gazeta Shqiptare / TVNews24 / Pashtriku.org* (27. 01. 2010); Për komentet, Cf. Xhezair Zaganjori, *Jurisprudencë dhe praktikë ndërkombëtare* (MORAVA: Tiranë, 2011) fq. 39-52 (hartues i vendimit ka qenë vetë profesor **Xhezair Zaganjori**, si referues i rastit; këtë ia ka thënë në një bisedë autorit të parë të këtij libri); Për vendet tjera ish komuniste, si dhe për modalitetet e kontrollit kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare gjetiu, Cf. Helmut Steinberger, "Models of Constitutional Jurisdiction", kapitulli I ("Review of the Constitutionality of Laws"), fq. 5-20.

juridiko-kushtetuese. Në këto raste, caqet e kontrollit kushtetues të amendamenteve kushtetuese janë më të gjëra se caqet e këtij kontrolli kur ndërmerret në zbatim të nenit 113.9 lidhur me nenin 144.3 të Kushtetutës. Në këtë rast nuk flitet për kapitujt I-III të Kushtetutës, por për respektim të germës dhe frymës së Kushtetutës si një tërësi organike e pandarë. Këtu flitet, për të qenë më të saktë, për detyrueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara sipas Kushtetutës por edhe të detyrimeve tjera jashtë kontraktuese që dalin nga e drejta zakonore ndërkombëtare. Edhe kontrolli i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur, u mor vesh, mund të jetë cak i kontrollit kushtetues. Në një rast të tillë do të ishte, ta zëmë, vlerësimi nëse marrëveshjet ndërkombëtare nga neni 18.1 (pikat 1-4) i Kushtetutës janë ratifikuar me votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve.

Pika e pestë dhe e fundit e nenit 113.3 të Kushtetutës përcakton juridiksionin e Gjykatës për të kontrolluar kushtetutshmërinë e zgjedhjeve për **Kuvendin e Kosovës**. Në kuptim të kësaj pike të këtij paragrafi, Gjykata është mekanizmi që vlerëson nëse standardet kushtetuese mbi zgjedhjet janë aplikuar në rastin e zgjedhjeve të përgjithshme në Kosovë. Logjika prapa këtij juridiksioni është që Gjykata të jetë mekanizmi që garanton se zgjedhjet e përgjithshme të jenë zhvilluar sipas Kushtetutës.[182] Meqë ky paragraf përbën një hapësirë shumë të gjerë juridiksionale, Gjykata realisht vishet me autoritetin e konsiderimit si të aspektit procedural kushtetues ashtu edhe të atij substancial në kuptim të kushtetutshmërisë së zgjedhjeve për Kuvendin. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së zgjedhjeve të tilla, në anën tjetër, e fut Gjykatën në konsiderimin jo thjeshtë të anës normative të zhvillimit të tyre, por edhe të anës tekniko-praktike, duke lejuar hapësirë që Gjykata realisht të konsiderojë çështjet e faktit, jo thjeshtë vetëm çështjet normative që lidhen me kushtetutshmërinë dhe infrastrukturën juridike për zgjedhjet.[183]

Juridiksioni i vënë me këtë paragraf ofron hapësirë që zgjedhjet për Kuvend, që është institucioni që kryen funksionin legjislativ dhe përfaqësues në Kosovë, t'i nënshtrohen kontrollit të gjyqësisë kushtetuese me qëllim të ndihmohet në ruajtjen e kredibilitetit kushtetues dhe politik të këtij institucioni me rëndësi shtetëror. Nga kjo dispozitë, siç mund të vërehet, nga kontrolli kushtetues përjashtohen zgjedhjet për formimin e organeve në nivele tjera si dhe cenimet e të drejtave dhe lirive kushtetuese gjatë procesit të zgjedhjeve për formimin e Kuvendit dhe të organeve të niveleve tjera. I vetmi rast që involvon Gjykatën jashtë rastit nga pika e pestë e nenit 113.3 të Kushtetutës është ai i certifikimit të zgjedhjeve nacionale sipas nenit 106.1 të **Ligji Nr. 03/L-073**[184], që përcakton kushtet e këtij certifikimi[185]. Mirëpo, këtu nuk flitet për juridiksion origjinal të Gjykatës, siç është rasti me vlerësimin e kushtetutshmërisë së zgjedhjeve për Kuvend nga pika e fundit e nenit 113.3 të Kushtetutës, por për një procedurë sipas kërkesës individuale në pajtim me dispozitat e nenit 113.7 të Kushtetutës që mund të jetë duke u zhvilluar në Gjykatë

---

182 Cf. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë**. Vendim nr. 1 i datës 7.1. 2005. *Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë* Nr.4, 25 janar 2005. Në këtë vendim, **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë** thekson se ndarja zonave zgjedhore duhet të bëhet sipas numërit të përafërt të zgjedhësve, ashtu siç e thotë Kushtetuta, jo siç ka bërë ligjvënësi shqiptar, duke përcaktar në **Kodin Zgjedhur** një kriter tjetër, kriterin e zgjedhësve që kanë marrë pjesë në votime. Përdorimi i këtij kriteri, pra të zgjedhësve që kanë marrë pjesë në votime, cenon të drejtat kushteteuse zgejdhore. Në Kosovë, fjala është jo për të drejtën e kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së infrastrukturës lighjore për zgjedhjet nacionale, por për kontrollin kushtetues të anës teknike të impelemntimit të zgjedhjeve nacionale që kanë të bëjnë me formimin e legjislaturës së re të radhës.

183 Në rastin e **Kroacisë**, **Gjykata Kushtetuese** ka vendosur që **Sabori** (Parlamenti) ka fuqinë ekskluzive për të vendosur për sistemin e zgjedhjes së anëtarëve të tij dhe të përcaktojë rregullat brenda sistemit që zgjedh. Zgjedhja e parlamentit nuk mundet **per se** të jetë subjekt i vlerësimit kushtetues para Gjykatës Kushtetuese, përveç në rastet kur një zgjidhje e caktuar e legjislaturës së re i cenon vlerat kushtetuese të garantuara të votimit universal dhe të barabartë apo parimet dhe vlerat tjera kushtetuese që lidhen me realizimin e sistemit demokratik shumë-partiak dhe përfaqësues. Cf. **The Constitutional Court of Croatia**. *Decision U-I-3789/2003 et al*. **Narodne Novine** 142/10. Identification: CRO-2010-3-016. Botuar në European Commission for Democracy through Law (Venicce Commission), *The Bulletin* (Strasbourg, October 2011) fq. 489-492.

184 "Ligji nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës" i datës 5 qershor 2008. **Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës** nr.31 (2008)

185 Neni 106 ["Rezultatet zgjedhore"] i **Ligji Nr. 03/L-073.** "1. KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotime dhe në qendrat e numërimit si dhe kur të gjitha vërejtjet e dala që u përkasin votimit dhe numërimit janë vendosur nga Komisioni Zgjedhor për Parashtresat dhe Ankesat dhe nga Gjykata Kushtetuese." Kjo dispozitë është shfuqizuar me amendamentimet e këtij ligji në vitin 2010. Cf. më shumë për këtë në fusnotat nr. 24, **supra**, dhe nr. 321, **infra**, në këtë seksion dhe teksti që i shoqëron.

dhe që duhet të pritet formalisht derisa të mbyllet si rast. Në këto raste, **Gjykata Kushtetuese** vlerëson nëse **Gjykata Supreme** si instancë e fundit ka cenuar me vendimmarrjen e saj të drejtat individuale nga neni 45 ["Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes"] i Kushtetutës, gjithnjë të interpretuara si të drejta në dritën e letrës, shpirtit dhe frymës së Kushtetutës (normat, principet dhe vlerat e konstitucionalizmit bashkëkohor).

11. 3. 4. Juridiksioni nga neni 113. 4 i Kushtetutës

Ky paragraf i këtij neni juridiksionin e Gjykatës për të kontrolluar kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve juridike të Qeverisë, të cilat cenojnë autoritetin kushtetues të komunave ose zvogëlojnë të hyrat e komunës. Kjo do të thotë se objekt i kontrollit kushtetues nuk mund të jenë aktet juridike të komunës dhe pajtueshmëria e tyre ndërmjet veti dhe me vetë kushtetutën.[186] Palë e autorizuar për të iniciuar këto çështje para Gjykatës është vetëm komuna.

Dispozita e tillë përbën dispozitën që garanton të drejtat e vetëqeverisjes lokale me të cilat janë të veshura komunat sipas dispozitave kushtetuese. Për të pasur të drejtë në iniciativë, sipas paragrafit në fjalë, komuna duhet që të jetë **prekur nga ligji apo akti në fjalë**. Sipas leximit tekstual të kësaj dispozite del se kjo prekje e komunës ndodhë çdo herë kur ligjet ose aktet e Qeverisë **cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës**. Kjo do të thotë që legjitimiteti procedural i një komune për të iniciuar çështje sipas këtij juridiksioni fitohet vetëm në atë moment kur **ligji apo akti juridik i Qeverisë** prek drejtpërdrejtë një interes të komunës që lidhet përgjegjësitë komunale ose zvogëlimin e të hyrave të komunës. Ky juridiksion nuk përbën një të drejtë të komunës për të iniciuar çështje përpara Gjykatës pa qenë e prekur nga një ligj apo akt juridik i Qeverisë që cenon përgjegjësitë komunale ose vogëlon të hyrat e komunës.

Në interpretimin logjik dhe teleologjik të kësaj dispozite dalin dy gjëra: e para, se Qeveria nuk nxjerrë ligje dhe se redaktimi në gjuhën shqipe i kësaj dispozite nga neni 113.4 i Kushtetutës ka kuptim vetëm nëse merret parasysh versioni në gjuhën angleze, në të cilën gjuhë është shkruar teksti origjinal i Kushtetutës së vitit 2008. Në gjuhën angleze me qeveri nuk nënkuptohet vetëm ekzekutivi por edhe organet tjera që ushtrojnë pushtet shtetëror, kurse me **ligj** (**law**) nuk nënkuptohet vetëm ligji që nxirret nga organi përfaqësues por edhe nga organet tjera të pushtetit shtetëror por që ka natyrë të përgjithshme, pa marrë parasysh emërtimin e tyre teknik. Të kësaj natyre janë, ta zëmë, rregulloret, udhëzimet, dekretet me fuqi ligjore etj. etj. Në rastin konkret, me ligj dhe akte të Qeverisë duhen nënkuptuar si aktet e përgjithshme që i nxjerr organi ekzekutiv ashtu edhe ato individuale: dy llojet e këtyre akteve kanë mundësi për të cenuar përgjegjësitë komunale ose për të zvogëluar të hyrat e komunës, përkatësisht për të prekur interesat e komunës. Po të interpretohej ndryshe kjo dispozitë, atëherë do të rezultonte se komunat mund të iniciojnë kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së ligjeve të Kuvendit të Kosovës që kanë të bëjnë me vetëqeverisjen lokale. Kjo nënkupton, e dyta, se të gjitha aktet e Qeverisë, të përgjithshme apo të veçanta, mund të jenë objekt i kontrollit kushtetues të iniciuar nga komuna në rastet kur ato **cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës.**

Gjykata, në ushtrimin e këtij juridiksioni, është e autorizuar që të kontrollojë kushtetutshmërinë e ligjeve dhe akteve juridike si më sipër sa i përket dy aspekteve:

- një, nëse një ligj apo akt i Qeverisë cenon autoritetin e komunave, pra vëllimin e kompetencave të qeverisjes lokale të cilat i takojnë komunave; dhe
- dy, nëse një ligj apo akt juridik i Qeverisë zvogëlon të hyrat financiare të komunës.

Jashtë këtyre dy bazave, komunat nuk kanë legjitimitet procedural për të iniciuar në Gjykatë çështje të tilla, në ndërkohë që vetë Gjykata në ushtrimin e këtij juridiksioni mund të futet edhe në terrenin e

[186] Si shembull krahasues, **Gjykata Kushtetuese e Sllovenisë** ka vendosur që nuk ka juridiksion për ta vlerësuar pajtueshmërinë reciproke të dispozitave të urdhrave komunale. (Vendim i Gjykatës Kushtetues të Sllovenisë U-I-196/97 i datës 29.10.1997).

pastër ligjor, duke e tejkaluar normat kushtetuese mbi këtë çështje, meqë substanca mbi të cilën mund të ushtrohet ky juridiksion, vetëqeverisja lokale, kërkon kalimin në çështje më detajuara që janë rëndom të specifikuara në normat relevante ligjore. I tillë ka qenë rasti me Aktgjykimin në rastin e përmendur më herët **KO 130/15** që ka pasur të bëjë me asociacionin e komunave me shumicë serbe.[187] Në këtë rast, Gjykata ka shtjelluar ekskluzivisht caqet e vetëqeverisjes lokale të serbëve të Kosovës, të formuluara në mënyrë hipotetike nga vetë Gjykata gjatë analizës së **aktit juridik** dhe **Statutit** të ardhshëm të Asociacionit.[188] Ky shtjellim i caqeve të tilla të vetëqeverisjes lokale është bërë me qëllim që dhënies së një përgjigje në pyetjen dhe dilemën e parashtruar nga pala e autorizuar, Presidentja e Kosovës, nëse një asociacion i komunave me shumicë serbe në Kosovë mund të operojë me autorizime nga e drejta publike. Gjykata, megjithatë, në arsyetimin e vet kundër pasjes së autorizimeve publike të asociacionit të ardhshëm të komunave me shumicë serbe në **Kosovë**, në mënyrë të gabuar ka cituar nenet e Kushtetutës që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë kolektive nga kapitulli II dhe III i Kushtetutës, të cilat asnjëherë nuk mund t'i referohen personave juridik nga e drejta publike, si dhe personave juridik – gjysmë shtetërorë, siç është menduar të jetë në të ardhmen asociacioni në fjalë.[189] Përveç kësaj, Gjykata në arsyetimin e vet të caqeve të vetëqeverisjes lokale në Kosovë ka marrë parasysh një rast dhe një situatë hipotetike, të cilat cilësohen si **akti juridik** dhe **Statuti**, të cilat pritet të ndodhin/draftohen/nxirren në të ardhmen me qëllim të vënies në jetë të detyrimeve të marra në **Bruksel** në vitin 2013.[190]

Objekt kontrolli kushtetues ka qenë, për pasojë, **një çështje kushtetuese** e parashtruar nga një **palë e autorizuar**, kurse detyrë e Gjykatës ka qenë përcaktimi nëse germa dhe fryma e Kushtetutës cenohen me këtë çështje kushtetuese, e cila deri në fund ka natyrë hipotetike dhe që nuk mund të subsumohet (nënvihet) nën asnjë dispozitë kushtetuese lidhur juridiksionin nga nenit 113 i Kushtetutës. Arsyetimi i Gjykatës për këtë juridiksion ka qenë fare i thjeshtë: meqenëse kjo përbën një çështje kushtetuese, sepse, si të tillë, e ka definuar vetë pala e autorizuar, në këtë rast Presidentja e Kosovës, **Atifete Jahjaga**, kjo përbën një çështje kushtetuese dhe, për pasojë, Gjykata ka juridiksion mbi një gjë të tillë sepse është i vetmi organ që ka juridiksion për të vendosur se çka është kushtetutë dhe kushtetuese në kontekstin kosovar.[191] A nuk duket kjo tautologji e pastër?! Objekti real i kontrollit kushtetues ka

---

187 Paragrafët 2 & 3 të aktgjykimit në rastin **KO 130/15**:
"[…] **Objekti i** çështjes: 2. Parashtresa përmban kërkesën për vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar *"Asociacioni/Bashkësia* i *komunave* me *shumice serbe ne Kosove -Parimet* e *përgjithshme/Elementet kryesore"* (ne tekstin e mëtejmë: Parimet) me frymën e Kushtetutës, me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta);
3. Konkretisht, parashtruesja kërkon që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) të përgjigjet në pyetjen vijuese:
"Duke marrë parasysh se Parimet e Asociacionit rregullojnë krijimin dhe funksionimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë, a janë në përputhshmëri këto parime dhe elemente me frymën e Kushtetutës, nenin 3, paragrafin 1 (natyra shumë-etnike), Kapitullin II (të drejtat dhe liritë themelore) dhe Kapitullin III (të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës?". "

188 Cf. paragrafi 189, pikat 1 – 6 të aktgjykimit në rastin **KO 130/15.**

189 Cf. paragrafi 17 i aktgjykimit në rastin **KO 130/15**.

190 **Marrëveshja e parë ndërkombëtare e parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë (Marrëveshja e Parë)**, nënshkruar më datën 19 prill 2013 në Bruksel në mes të kryeministrit të Kosovës dhe kryeministrit të Serbisë, ratifikuar në Kuvendin e Kosovës më datën 27 qershor 2013, me **Ligjin nr 04/L-199 për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.** *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* nr. 38/2013, datë 17 korrik 2013. Kuvendi i Kosovës para nënshkrimit ka dhënë leje që kryeministrit I Kosovës të marrë përsipër në emër të Kosovës një detyrim të tillë, me vendimin e vet 01/132 të datës 28 maj 2013. Më 12 shtator 2013, ndërkaq, me Dekretin nr. DL-050-2013, Presidentja e Republikës së Kosovës, **A. Jahjaga**, ka shpallur Ligjin nr. 04/L-199. Kjo do të thotë se në aspektin kushtetues çdo gjë është spastruar që në fillim përmes marrjes së mandatit të plotë nga organi përfaqësues dhe përfaqësuesi i unitetit kushtetues të kosovarëve.

191 Paragrafët 88-102 & 108-109 të aktgjykimit në rastin 130/15.

qenë një marrëveshje ndërkombëtare e lidhur në mes të dy shteteve sovrane dhe të pavarura, **Marrëveshja e Dytë**,[192] në kuadër të zbatimit të zotimeve të marra me një marrëveshje tjetër të mëhershme ndërkombëtare (**Marrëveshja e Parë**), kurse parametër i vlerësimit kanë mundur të jenë vetëm normat kushtetuese nga nenet 17-19 të Kushtetutës, norma që përcaktojnë në mënyrë të qartë llojet, rolin dhe pozitën e marërveshjeve dhe të drejtës ndërkombëtare në rendin kushtetues kosovar.[193]

Si mendimi i shumicës në rastin **KO 130/15,** ashtu dhe mendimi mospajtues,[194] kanë provuar t'i ikin çështjes së objektit kushtetues dhe, për pasojë, kanë përdorur parametra tërësisht të gabuar të kontrollit kushtetues mbi një objekt që nuk ekziston, duke e kthyer një çështje të raportit në mes të drejtës së brendshme dhe të drejtës ndërkombëtare në një çështje të vetëqeverisjes lokale, diçka që nuk është. Sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare dhe çdo teksti shkollor mbi të drejtën ndërkombëtare publike, si marrëveshje ndërkombëtare në mes të dy shteteve quhet ajo marrëveshje që lidhet në mes të shteteve sovrane e të pavarura, pa marrë parasysh njohjen, si dhe pa marrë parasysh formën e lidhjes, me shkrim apo me gojë. E drejta kushtetuese, më pastaj, normon vendin dhe rolin e marrëveshjeve dhe të së drejtës ndërkombëtare në kuadër të sistemit të brendshëm juridik: vetë e drejta ndërkombëtare nuk diskriminon në mes të shteteve të njohura dhe atyre të panjohura, si dhe në mes të anëtarëve të **OKB**-së dhe atyre që

---

192 Fjala është për **Marrëveshjes mbi parimet e përgjithshme të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe**, nënshkruar më datën 25 gusht 2015 në Bruksel (**Marrëveshja e Dytë**), po ashtu nga dy kryeministrat respektiv të Kosovës dhe Serbisë. Kjo marrëveshje, të cilës këtu i referohemi si Marrëveshja e Dytë, nuk u ratifikua asnjëherë, sepse nuk ka pasur nevojë meqë paraqet normë të përgjithshme impelemntuese nga neni 18.3 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare "] i Kushtetutës, dispozitë kjo që në tërësi përputhet me të drejtën zakonore ndërkombëtare të traktateve që nuk kërkon asnjë autorizim (plotëfuqi) për ratifikim të një marrëveshje nga ana e shefit të shtetit, kryeministrit dhe ministrit të jashtëm. Si mendimi i shumicës në rastin **KO 130/15**, ashtu dhe mendimi mospajtues, si duket mendojnë që **Marrëveshja e Dytë** nuk ka statusin e një akti juridik dhe, për pasojë, nuk mund të jetë objekti kontrolli kushtetues. Objekt kontrolli, sipas tyre, mund të jenë vetëm aktet juridike që përmenden në **Marrëveshjen e Dytë**, dekreti dhe Statuti, të cilët normojnë respektivisht themelimin dhe funskionimin e Asociiacionit. Kjo, u mor vesh, përbën një mosnjohje tragjike të natyrës së marrëveshjeve në të drejtën ndërkombëtare dhe vendit të tyre në sistemin juridik kosovar, i cili sistem në thelb i takon zgjidhjeve kushtetuese të shumicës së vendeve ish-komuniste të **Evropës.** Kjo është kështu për dy arsye: e para, cilësia e një marrëveshje ndërkombëtare në mes të shteteve nuk përcaktohet nga forma (me shkrim apo me gojë), statusi ndërkombëtar i shtetësisë së një shteti (i njohur apo i panjohur, i konsoliduar apo i pakonsoliduar), si dhe nga zgjidhja kushtetuese në një shtet sa i përket pozitës dhe efekteve të marrëveshjeve dhe të së drejtës ndërkombëtare në rendin e brendshëm kushtetues (kërkesa për ratifikim parlamentar apo ratifikim tjetër). ajo çfarë çon peshë është që marrëveshja në mes të palëve duhet të jetë rezultat i vullnetit të lirë në mes të dy shteteve, të njohura ose jo, e njohin njera tjetrën apo nuk e njohin, si dhe vetëdija reciproke në bazë të rrerthanave të rastit se për hyrje në një marrëveshje të tillë palët nuk kanë pengesa dhe kufizime kushtetuese; e dyta, **Marrvëeshja e Dytë** për nga natyra juridike-ndërkombëtare dhe kushtetuese përbën një akt të përgjithshëm implementues të **Marravëshjes së Parë**. Meqenëse **Marrëveshja e Parë** ka qenë objekt i kontrollit kushtetues dhe Gjykata ka gjetur, me plot të drejtë, se nuk ka juridiksion për kontroll kushtetues, atëherë kushtetutshmëria e saj prezumohet. Kjo rrethanë, në kuptim të ngushtë **per constitutionem**, përjashton çdo mundësi për kontroll kushtetues të marrëveshjes implementuese që është ratifikuar me nënshkrim nga kryeministri i Kosovës më datën 25 gusht 2015, sipas autorizimit kushtetues nga neni 18.3 të Kushtetutës. Më tutje se kaq, kjo nënkupton se vetëm kontrolli i konvencionalitetit mund të ushtrohet në rastin e dy marrëveshjeve në të ardhmen, përkatësisht vetëm kontrolli kushtetues për të parë nëse akti juridik i Qeverisë me të cilin do të themelohet Asociacioni si dhe Statuti i Asociacionit, bien ndesh me dispozitat e **Marrëveshjes së Parë** dhe të **Marrëveshjes së Dytë**. Këtë dhe çështjet tjera lidhur me to do t'i shtjellojmë sërish në pjesën për **aktivizmin gjyqësor**, në kapitullin e katërmbëdhjetë, sepse paraqet rastin më të dukshëm të gabimeve themelore të natyrës serioze kushtetuese të Gjykatës, si pasojë e një **aktivizmi gjyqësor** që kufizohet me arbitraritet. Cf. më shumë edhe në. Enver Hasani, "The case of the Serb Association before the Constitutional Court of Kosovo". Në Andrzej Szmyt and Boguslaw Banaszak (eds.),*Transofrmation of Law Systems in Central, Eastern and Southeastern Europe in 1989-2015* (Gdansk University Press: Gdansk, 2016) fq. 493-518.

193 Obligimi ndërkombëtar i Kosovës, i marrë me ratifikimin e **Marrëveshjes së Parë**, për më tepër, siç u tha më sipër, është kontrolluar nga **Gjykata Kushtetuese**, e cila ka gjetur se në **Kosovë** nuk ekziston kontrolli kushtetues i marrëveshjeve ndërkombëtare, as **preventiv** (para ratifikimit) as **represiv** (pas ratifikimit). Këtë vendim Gjykata e ka dhënë duke u mbështetur në praktikën komparative kushtetuese dhe ndërkombëtare lidhur me vendin dhe pozitën e marrëveshjeve dhe të drejtës ndërkombëtare në rendin e brendshëm juridik si dhe duke u mbështetur në standardet aktuale lidhur me raportin në mes të drejtës së brendshme dhe të drejtës ndërkombëtare. Cf. *Rasti KO 95/13. Aktgjykim. Parashtrues: Visar Ymeri dhe 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit, Nr. 04/L-199, për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të Planit të zbatimit për këtë marrëveshje*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.:AGJ469/13. Prishtinë, më 9 shtator 2013. Paragrafët. 48-69 & 71-101.

194 Cf. *Mendim mospajtues i gjyqtarit Bekim Sejdiu ne rastin K0 130/15.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.: MM 878/15. Prishtinë, 23 dhjetor 2.015.

nuk janë të tilla. Përkundrazi, e drejta ndërkombëtare u ofron mbrojtje të njëjtë të gjitha shteteve sovrane dhe të pavarura, pa marrë parasysh njohjen e tyre. Kësaj çështje i kthehemi sërish kur të flasim për **aktivizimin gjyqësor** në kapitullin katërmbëdhjetë. Tani ti kthehemi çështjes së paragrafit të katërt të nenit 113 të Kushtetutës.

Duhet të thuhet, fare në fund, që ky paragraf përbën një hapësirë të kontrollit kushtetues të raportit në mes të pushtetit qendror dhe atij lokal dhe se Kushtetuta e vë këtë mekanizëm si një garantues i ndarjes vertikale të pushtetit qendror dhe lokal, dhe balancit kushtetues në mes tyre. Kjo procedurë, e kuptuar në këtë mënyrë, dallon dukshëm nga procedura të cilën mund ta fillojë zëvendëskryetari për komunitete në bazë të nenit 62.4 ["Përfaqësimi në Organet e Pushtetit Lokal"] të Kushtetutës.[195] Kjo procedurë dallon dukshëm nga procedura sipas nenit 113.4 të Kushtetutës.

Pikë së pari, procedura sipas nenit 62.4 është individuale, që do të thotë se zhvillohet në bazë të nenit 113.7 ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] të Kushtetutës. Përveç kësaj, në rastet e ngritura sipas nenit 62.4 të Kushtetutës nuk kërkohet **shterja e të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj**, siç kërkohet në fjalinë e fundit të nenit 113.7 të Kushtetutës. Një dallim tjetër i rasteve nga nenit 62.4 me këto që normohen me nenin 113. 4 konsiston në faktin se sipas paragrafit 4 të nenit 62 të Kushtetutës, zëvendëskryetari mund të parashtrojë çështjen drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese me objekt kontrolli kushtetuese një akt apo vendim i kuvendit të komunës, u mor vesh nëse ai/ajo mendon dhe vlerëson se këto akte apo vendime të kuvendit të komunës i shkelin të drejtat e komuniteteve jo shumicë të garantuara me Kushtetutë. Këtu kemi të bëjmë me kërkesa individuale të komuniteteve jo shumicë të cilat garantohen sipas kapitullit III ["Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre"] të Kushtetutës dhe që pohohet se janë shkelur me aktet të kuvendit komunal. Ky interpretim është konfirmuar në jurisprudencën e Gjykatës në lëndën e njohur si **rasti i logos së Prizrenit.** Në këtë rast u shpall si jo kushtetues neni 7 i **Statutit të Komunës së Prizrenit** sepse nuk reflektonte identitetin e të gjitha komuniteteve që jetojnë në këtë komunë, përkatësisht u konstatua se logoja e Prizrenit reflektonte vetëm identitetin nacional të komunitetit shumicë, duke përjashtuar komunitetet tjera.[196] Kjo, sipas Gjykatës, përbënte "[...] shkelje të të drejtave të komuniteteve jo shumicë në Prizren për të ruajtur, mirëmbajtur dhe promovuar identitetin e tyre".[197]

11. 3. 5. Juridiksioni nga neni 113. 5 i Kushtetutës

Neni 113.5 përbën një **juridiksion plotësues** të nenit 113.2. Përderisa neni 113.2 e autorizon një të katërtën (1/4) e Kuvendit, që të mund të ngritin para Gjykatës çështjen e kushtetutshmërisë së ligjeve brenda afatit gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi, neni 113.5 e autorizon një pakicë deputetësh prej se paku dhjetë (10) vetash, që të iniciojnë para Gjykatës çështjen e kontrollit të kushtetutshmërisë së një ligji apo vendimit të Kuvendit.[198] Neni 113.5, prandaj, është një autorizim për një **minorancë parlamentare** që të shfrytëzojë mundësinë për të kontestuar kushtetutshmërinë e ligjeve dhe vendimeve të Kuvendit, pavarësisht vullnetit të shumicës parlamentare, brenda një afati të përcaktuar kohor, para se prodhimi i miratuar nga Kuvendi të hyjë në fuqi. Këtu fjala është për kontroll preventiv (**ex ante**), jo represiv (**ex post**), të kushtetutshmërisë së prodhimit të Kuvendit, për dallim nga kontrolli represiv nga neni 113.2 (1) i Kushtetutës.

---

[195] Neni 62 ["Përfaqësimi në Organet e Pushtetit Lokal"] I Kushtetutës. "[…] 4. Në rast se kuvendi i komunës vendos që të mos rishqyrtojë aktin a vendimin e vet, ose nëse zëvendëskryetari vlerëson se, edhe pas rishqyrtimit rezultati përbën shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, ai/ajo mund të parashtrojë çështjen drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese, e cila mund të vendosë nëse do të pranojë ta shqyrtojë rastin përkatës."

[196] *Rasti KO 01/09. Aktgjykim. Qemajl Kurtishi kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Ref. Nr.: AGJ 07/10. Prishtinë, më 18 mars 2010. Paragrafët 52-56.

[197] Ibid., pika II e pjesës operative të aktgjykimit.

[198] Sikundër dihet, gjuha shqipe dhe gjuha serbe janë gjuhë kushtetuese me status të barabartë. Në versionin në gjuhën serbe të kësaj dispozite mungon fjala **vendim**. Një gjë e tillë mund të kuptohet sikur këto akte juridike të Kuvendit nuk mund të jenë objekt kontrollit kushtetues. Kjo, megjithatë, nuk është kështu sepse dy versionet janë të barabarta dhe kanë efekt të njëjtë. Sikundër e kemi thënë më herët, origjinali i Kushtetutës së vitit 2008 është në gjuhën angleze kurse versionet në gjuhen shqipe dhe serbe janë përkthime nga origjinali anglisht. Për këtë arsye, ky lëshim duhet të shihet si një lëshim i bërë gjatë përkthimit.

Shikuar në kuptim të demokracisë parlamentare, neni 113.5 përbën një mekanizëm shumë efektiv përmes së cilit një grup i vogël deputetësh, një pakicë prej dhjetë (10) vetash, të mund të kontestojnë një ligj apo vendim të shumicës në Kuvend për shkak të kundërkushtetutshmërisë së supozuar. Kjo hapësirë juridiksionale, prandaj, është një rrugë shumë efikase që e fuqizon kontrollin parlamentar që një opozitë mund t'i bëjë vendimeve të shumicës, duke i dhënë mundësi Gjykatës që të luaj rolin saj kushtetues: grupi prej së paku dhjetë (10) deputetësh i hapin rrugë kundërbalansimit të një prodhimi potencialisht kundërkushtetues të Kuvendit. Ky paragraf, thënë me fjalë të tjera, përbën një autorizim procedural kushtetues për një **pakicë në parlament** që i jep asaj mundësi që të shfrytëzojë të mirat e një kontrolli të pavarur kushtetues.[199] Pa dyshim që kjo procedurë është e shëndetshme për kuptimin e demokracisë parlamentare. **Komisioni i Venedikut**, megjithatë, nuk ka menduar kështu kur e ka kundërshtuar një qasje të tillë kushtetuese, duke konsideruar që një autorizim i tillë për një numër kaq të vogël të deputetëve mund të stërngarkojë gjykatat kushtetuese.[200] Doktrina mbi gjyqësinë kushtetuese e ka kundërshtuar po ashtu, por me argumente të tjera: kjo procedurë mund ta fusë gjyqësinë kushtetuese në çështje shumë politike dhe ta shndërroj në një aktor politik, mendojnë disa autorë.[201]

Këto qasje janë gabim sepse, fundja, vetëm ideja e lindjes së gjyqësisë kushtetuese është bazuar në ndarjen e saj nga gjyqësori i rregullt me qëllim që e njëjta të kryejë gjykimin e kushtetutshmërisë së ligjeve. Kritikat mund të bëhen dhe do të vazhdojnë, por realiteti është që kjo procedurë, si në Kosovë ashtu dhe vendet tjera ish komuniste, ka qenë dhe mbetet instrument kyç i kontrollit dhe zbutjes së demokracisë radikale (populliste).[202] Kjo ka qenë esenca e debatit **Kelsen – Shmit** dhe e vetë idesë së lindjes së gjyqësisë kushtetuese. Dëmi nga demokracia e shumicës u pa në mes të dy luftërave botërore dhe tragjedinë që pasoj në **Luftën e Dytë Botërore**. A nuk janë duke u restauruar viteve të fundit (2016-2018) në dy anët e **Atlantikur** rrymat populiste?! Demokracia kushtetuese (parlamentare apo presidenciale) ka lindur në luftën për kontroll të pushtetit, njëherë si kontroll social-klasor, pra si kontroll i bazuar në privilegjet e shtresave të caktuara, për t'u bërë në fund të shekullit XVIII në dy anët e **Atlantikut** si ide dhe përvojë universale. Në këtë kontroll të pushtetit me të cilin asocohet bota liberale perëndimore, gjyqësia kushtetuese ka luajtur një rol të jashtëzakonshëm përmes kontrollit të kushtetutshmërisë së normave të përgjithshme dhe, për pasojë, të vullnetit të shumicës që të mos degjenerojë në tirani.

E parë në lidhje me nenin 113.2, dispozita e nenit 113.5 të Kushtetutës vendos disa kufij në ushtrimin e kësaj të drejte: përderisa neni 113.2 e autorizon Kuvendin që të ngre çështjen e kontrollit kushtetues të ligjeve para Gjykatës pas hyrjes së tyre në fuqi brenda gjashtë (6) muajsh, neni 113.5 i jep këtë të drejtë një pakicë në Kuvend prej dhjetë (10) deputetësh vetëm brenda një periudhe kohore prej dhjetë (10) ditësh nga miratimi i një prodhimi në Kuvend. Në këtë kuptim, pakica prej dhjetë (10) deputetësh detyrohet që, ose ta shfrytëzojë këtë të drejtë kushtetuese brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore, ose që ta humbasë autorizimin, dhe që çështja pastaj të mund të ngrihet me kërkesë nga ana e një të katërtës (1/4) së numrit të tërësishëm të deputetëve. Ky autorizim që e kufizon këtë të drejtë të një grupi prej dhjetë (10) deputetësh në një kohë mjaft të shkurtër duhet të kuptohet në tërësinë e vet: kjo procedurë

---

199 Në literaturë është vërejtur se në kontesktin kosovar kjo dispozitë është futur me qëllim të mbrojtjes së pakicave etnike kosovare nga majorizimi i popullsisë shumicë. Cf. Dren Doli & Fisnik Korenica, "Kosovar Constitutional Court's Jurisdiction: Searching for Strengths and Weaknesses", fq. 813.

200 Cf. në rastin e **Moldavisë**: European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), "Opinion on the Draft Law on the Constitutional Court and Corresponding Amendments of the Constitution of the Republic of Moldova" *Opinion no.200/2002. CDL-AD (2002) 16* (Strasbourg, 15 July 2002).

201 Lee Epstein, Jack Knight & Olga Shvetsova, (2001) "The Role of Constitutional Courts in the Establishment and Maintenance of Democratic Systems of Government". *Law and Society Review*. Vol. 35 No. 1 (2001) fq. 117–164 (që citon një intervistë nga **Leonid Nikitinsky** me **Boris Ebzeev** me titull "Justice of the Constitutional Court of the Russian Federation", botuar në *East European Constitutional Review* Vol. 6 No. 1 (1997), fq. 83–87.

202 Ky segment i demokracisë kushtetuese, pra e drejta e një organi të pazgjedhur nga populli, paraqet pikën rreth të cilës sillet vërdallë debati mbi vetë legjitimitetin e gjyqësisë kushtetuese. Në diskursin akademik të së drejtës kushtetuese kjo njihet, siç u theksua më herët, si **dilemë kundermazhoritare**, dilemë që ende nuk ka gjetur zgjidhje dhe vazhdon të torturojë doktrinën dhe praktikën kushtetuese. Cf. më shumë për këtë në Or Bassok and Yoav Dotan, "Solving the countermajoritarian difficulty? "*International Journal of Constitutional Law*, Volume 11, Issue 1 (January 2013) fq. 13–33.

që mund të niset nga dhjetë veta ka afat të kufizuar pikërisht për të fuqizuar zërin e pakicës, që përbën pasurinë e një demokracie parlamentare, por duke e shkurtuar afatin, në të njëjtën kohë, shkurtohet edhe mundësi e gjatë e pakicës për të abuzuar me këtë procedurë.

Përveç autorizimit për të ngritur kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve, neni 113.5 i autorizon të paktën dhjetë (10) deputetë që të mund të iniciojnë kontrollin edhe të kushtetutshmërisë së **vendimeve** të Kuvendit, një prodhim tjetër ky i Kuvendit. Juridiksioni për të kontrolluar **vendimet** e Kuvendit, në kuptim të nenit 113.5, përbën një hapësirë shumë të gjerë juridiksionale për Gjykatën dhe një kanal shumë efikas për një pakicë në parlament për të kundërbalansuar vendimet e shumicës përmes kërkesës për kontroll të tyre kushtetues. Termi **vendim** i shfrytëzuar nga neni 113.5 i referohet çdo veprimi të Kuvendit, i cili prodhon pasoja juridike dhe që është marrë në vijim të ushtrimit të kompetencave të tij kushtetuese. Ai përfshin jo thjeshtë një akt juridik që është miratuar gjatë ushtrimit të kompetencave kushtetuese të Kuvendit, por veprimin e këtij të fundit përmes së cilit është bërë nxjerrja e **vendimit** me të cilin prodhohen pasojat juridike**, pra votimi në Kuvend**.

Kontrolli i kushtetutshmërisë këtu përfshin si formën ashtu dhe përmbajtjen. Kjo e fundit, pra përmbajtja e një vendimi, mund të jetë objekt i kontrollit kushtetues por që vetë vendimi i miratuar në Kuvend mos të ketë fuqi normative. Në një rast të tillë, kontrolli i kushtetutshmërisë së përmbajtjes së vendimit nuk ka asnjë vlerë. I tillë është rasti me vendimin për miratimin e ligjit për ratifikim të një marrëveshje ndërkombëtare. Vendimi i tillë i Kuvendit për miratim të një ligji nuk ka vlerë normative përveç që e fut në rendin juridik kosovar një marrëveshje ndërkombëtare, e cila pastaj mund të ketë efekte juridike në Kosovë.[203] Në aspektin procedural, gjërat qëndrojnë ndryshe: çdoherë vendimi i Gjykatës që konstaton shkelje të procedurës për marrje të vendimit në Kuvend prodhon pasoja të menjëhershme ndaj vendimit të tillë jo kushtetuese. Në rastet kur vendimi ka fuqi normative, siç është rasti, ta zëmë, me vendimet për zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, për zgjedhjen e anëtarëve të institucioneve e organeve kushtetuese, si dhe për zgjedhjen e vetë organeve kushtetuese që përbëjnë kompetenca të Kuvendit, Gjykata ka autorizim, sipas nenit 113.5, për të kontrolluar kushtetutshmërinë e **vendimeve** të tilla të Kuvendit.[204] Nga kjo shihet se autorizimi sipas këtij neni përbën një hapësirë shumë të gjerë dhe të komplikuar juridiksionale të Gjykatës, përmes së cilës, ajo mund të kontrollojë çdo vendim të Kuvendit: çdo **veprim** i Kuvendit që prodhon pasoja juridike (i përgjithshëm apo individual), qoftë i lëshuar në formë të shkruar apo të pashkruar, si në lidhje me çështje substanciale ashtu edhe me çështje procedurale, mund t'i nënshtrohet kontrollit kushtetues. Kjo nuk është situata me nenin 113.2 (1). në kuptim të këtij neni, kontrolli kushtetues mund të ndodhë vetëm në mënyrë **represive** dhe përfshinë vetëm ligjet si prodhim primar i Kuvendit, në ndërkohë që kontrolli sipas nenit 113.5 ka natyrë **preventive**. Vendimi i Kuvendit, qoftë ai me të cilin miratohet një ligj apo vetë ligji si prodhim primar i tij, si dhe vendimet që nxirren gjatë ushtrimit të kompetencave kushtetuese të organit përfaqësues dhe ligjvënës, kur dërgohen në

---

[203] Në disa jurisprudenca, si në rastin e **Rusisë**, Gjykata nuk ka juridiksion represiv për të kontrolluar kushtetutshmërinë e traktateve, njëjtë si në Kosovë, diçka që ajo e bën vetëm përmes kontrollit kushtetues të kushtetutshmërisë së ligjeve përmes së cilave është bërë ratifikimi i traktateve. Cf. më shumë për këtë dhe përvojat komparative në Gennady M. Danilenko, "The New Russian Constitution and International Law", *The American Journal of International Law* Vol. 88 No. 3 (1994) fq. 451-470.

[204] Rasti më i rëndësishëm në praktikën e **Gjykatës Kushtetuese të Kosovës** është i njohur si **rasti Pacolli**, kur Gjykata shpalli jokushtetues vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vendimin Nr. 04-V-04, përkitazi me zgjedhjen e **Presidentit të Republikës së Kosovës** të 22 shkurtit 2011. Me këtë rast, Gjykata gjeti mangësi kushtetuese si në formën ashtu dhe në përmbajtjen e vendimit në fjalë.
Gjykata në rastin si më sipër konstatoi se mosprania e një numri prej dy të tretave (2/3) të deputetëve me rastin e fillimit të zgjedhjes së shefit të shtetit kosovar paraqiste një cenim të kushtetutës nga ana e Kuvendit sepse ky cilësim i votës së deputetëve, sipas Gjykatës, ishte bërë për të treguar peshën e madhe që ka zgjedhja e institucionit të shefit të shtetit. Këtu nuk flitej për **kuorum**, gjë që është diçka tjetër, por për prezencën e dy të tretave (2/3) me rastin e fillimit të votimit për shefin e shtetit. E njëjta vlen edhe për kandidatët, dy ose më shumë, siç e thotë Kushtetuta, të cilët duhet të garojnë në garën për President. Nisja e votimit me më pak se dy të tretat (2/3) dhe me vetëm një kandidat paraqiste, sipas Gjykatës, cenim të Kushtetutës nga ana e Kuvendit, të atyre dispozitave që flasin dhe sankcionojnë pozitën dhe rolin e shefit të shtetit në një sistem parlamentar siç është Kosova. Cf. Paragrafët 63-87 të *Rasti KO 29/11. Aktgjykim. Parashtrues: Sabri Hamiti dhe Deputetët e tjerë. Vlerësimi Kushtetues i Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 04-V-04, Përkitazi me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës të 22 shkurtit 2011*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Ref. No.. AGJ 107/11. Datë: 30 mars 2011.

Gjykatë, duhet të presin verdiktin e saj dhe nuk mund të hyjnë në fuqi pa marrë mendimin e saj. Për ligjet, nënkuptohet se nuk mund të shpallen nga Presidenti para verdiktit të Gjykatës, kurse për vendimet nuk mund të hyjnë në fuqi. Prodhimi i këtij efekti juridik të vendimeve të Gjykatës të dhëna sipas nenit 113. 5 të Kushtetutës është i rregulluar me nenin 43.2 të **Ligjit Nr. 03/L-121.**[205]

11. 3. 6. Juridiksioni nga neni 113. 6 i Kushtetutës

Ky nen përcakton juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese për të konstatuar nëse **Presidenti i Republikës** ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës. Iniciativa për të ushtruar juridiksionin sipas këtij paragrafi mund të paraqitet nga së paku tridhjetë (30) deputetë të Kuvendit. Në rastin **KO 47/10**,[206] Gjykata ka ushtruar juridiksionin e saj për të kontrolluar nëse Presidenti i Republikës, sipas këtij paragrafi, kishte bërë shkelje serioze të Kushtetutës.

Pyetja themelore në këtë rast ka qenë nëse kërkesa mund të ishte e pranueshme, jo vetëm për shkak se pas deponimit të saj nga tridhjetë (30) deputetë, disa nga ta kishin hequr dorë nga kërkesa disa ditë më pas, por edhe për shkak të afatit të lejueshëm ligjërisht për paraqitjen e një kërkese të tillë. Lidhur me çështjen e parë, Gjykata konstatoi se shfrytëzimi i këtij autorizimi nga ana e tridhjetë (30) deputetëve përbën ushtrim të një të **drejte kolektive** ashtu që heqin dorë nga kërkesa e disa prej tyre pas një kohe të caktuar nuk mund të rezultojë në ndërprerje të procedurës së tillë të iniciuar përmes ushtrimit të një të drejte kolektive.[207] Për çështjen e dytë, Gjykata ka thënë se afati kohor prej tridhjetë (30) ditësh nga kryerja e shkeljes serioze, siç përcaktohet me nenin 45 të **Ligjit Nr. 03/L-121,**[208] vlen vetëm për situatat që kanë ndodhur vetëm një herë apo që kanë qenë të vazhdueshme, por që janë ndërprerë në të kaluarën dhe nuk ndodhin më.[209]

T'i kthehemi tani thelbit të paragrafit 6 të nenit 113. Dy janë çështjet substanciale që lidhen me këtë paragraf:

- një, kuptimi i konceptit të **shkeljes serioze** sipas këtij paragrafi; dhe,
- dy, **efekti juridik i vendimit** të Gjykatës në rast se konstatohet që Presidenti ka bërë shkelje serioze të kushtetutës.

Sa i përket çështjes së parë, në rastin **KO 47/10**, Gjykata ka zhvilluar një formulë logjike mbi bazën e së cilës mund të vlerësohet nëse shkelja kushtetuese e **Presidentit të Republikës** është **e rëndë.**[210] Sht-

---

[205] Neni 43.2 ["Afati"] i **Ligjit Nr. 03/L-121: "[…]** 2. Në rast kur ligji apo vendimi i miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës se Kosovës kontestohet sipas nenit 113, paragrafi 5 i Kushtetutës, ligji apo vendim i tillë mund t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestuar"; Për komentet, si dhe jurisprudencën e Gjykatës në këtë aspekt, cf. Gjyljeta Mushkolaj, Visar Morina & Johan Van Laemon, *Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Komentar* (GIZ GmbH, Projekti Reforma Juridike në Kosovë: Prishtinë, 2014) fq. 332-336.

[206] *Rasti KO 47/10. Aktgjykim. Parashtrues: Naim Rrustemi dhe 31 Deputetë Tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kundër Shkëlqesisë së tij, Fatmir Sejdiu, President i Republikës së Kosovës.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.: AGJ 43/10). Datë: 28 shtator 2010.

[207] Ibid., paragrafët 38 & 43-45.

[208] Neni 45 ["Afatet"] i **Ligjit Nr. 03/L-121:** "Kërkesa duhet të parashtrohet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve që nga dita kur shkelja e pretenduar kushtetuese nga ana e Presidentit është bërë publike".

[209] Rasti **KO 47/10**, aktgjykimi, paragrafët 34 & 35.

[210] Ibid., paragrafët 69 & 70 të aktgjykimit:
"[...] 69. Me qellim qe të konsiderojmë nëse kjo është vetëm një **shkelje teknike** e Kushtetutës ose **shkelje serioze**, Gjykata duhet te vlerësojë ndikimin e vendimit të Presidentit mbi besueshmërinë e publikut në zyrën e **Presidentit të Republikës së Kosovës**. Duke pasur parasysh kompetencat e konsiderueshme të dhëna në baze të Kushtetutës, është e arsyeshme që **publiku** të presupozojë se Presidenti i tyre, që "përfaqëson unitetin e popullit" dhe jo një fragment ose interes politik partiak, do të përfaqësojë të gjithë ata. Çdo qytetar i Republikës gëzon të drejtën që të sigurohet nga paanshmëria, integriteti dhe pavarësia e Presidentit. Kjo për më tepër, kur ai ushtron zgjedhje politike si kur zgjedh kandidatë konkurrentë nga koalicione të mundshme për t›u zgjedhur Kryeministër".
"70. Opinioni i Gjykatës është se kjo nuk mund të ndodhë kur Presidenti ende mban post shumë të lartë në një nga partitë politike më të njohura në vend dhe arrin në përfundimin se Presidenti ka kryer shkelje serioze te Kushtetutës sipas nenit 88.2 të Kushtetutës, duke vazhduar të lejojë vetveten të figurojë i regjistruar si Kryetar i **LDK-**së".

jellimi juridik i konceptit **shkelje e rëndë e kushtetutës**, nën dritën e rastit **KO 47/10,** bazohet në këto katër karakteristika:

- që, shkelja kushtetuese të prekë substancën e një dispozite themelore të Kushtetutës, gjë që kërkon të provohet se **Presidenti i Republikës**, në ushtrimin e pozitës së tij kushtetuese ka shkelur një normë të përcaktuar në mënyrë eksplicite në Kushtetutë;
- që, shkelja e bërë të ketë efekte praktike në jetën publike, gjë që kërkon që të provohet se në kryerjen e shkeljes së tillë, **Presidenti i Republikës** i ka privuar të tjerët nga gëzimi i një garancioni kushtetues dhe që privimi i tillë ka qenë real;
- që, shkelja e bërë të jetë e pakthyeshme dhe që nuk mund të riparohet/restaurohet nga ana e tij/saj, ashtu që pasojat e saj reflektojnë në rendin juridik në mënyrë praktike. Kjo nënkupton se e vetmja mënyrë e ndërprerjes së shkeljes së tillë dhe e rikthimit të gjendjes kushtetuese në mënyrë të besueshme është përmes këputjes së mandatit të Presidentit të Republikës; dhe, së fundi,
- që, Gjykata të evidentojë dhe ndërtojë pasojat që janë krijuar nga një shkelje e tillë e rëndë kushtetuese nga ana e Presidentit të Republikës dhe të faktojë ndikimin kundërkushtetues që shkelja e tillë ka prodhuar në jetën publike.

Ky juridiksion i Gjykatës e bën të nevojshme që, praktikisht, përveç kontrollit juridik të konstatohen edhe faktet mbi të cilat mbështetet shkelja e tillë e supozuar. Neni 113.6, në këtë aspekt, e shndërron Gjykatën në një vlerësues fakti sepse nga ajo kërkohet që ndikimi i shkeljes së tillë të Presidentit të provohet edhe në aspektin faktit të ndodhisë së ngjarjes jetësore që cilësohet si shkelje serioze kushtetuese.[211]

Sa i përket çështjes së dytë, dy nene janë që duhen parë në lidhmëni me këtë kompetencë të Gjykatës, neni 91.3 ["Shkarkimi i Presidentit"] dhe neni 116.1 [Efekti Juridik i Vendimeve] i Kushtetutës. Pa këto dy nene, duket sikur Kuvendi ka diskrecion të vendosë lidhur me shkarkimin e Presidentit të gjetur në shkelje të rëndë të Kushtetutës nga ana e Gjykatës. Në fakt, fjalia e fundit e nenit 91.3 e bën të dyshimtë natyrën juridike të vendimit të Gjykatës me të cilin konstatohet shkelja e rëndë e Kushtetutës.[212] Përdorimi i fjalës **mund** në këtë nen sikur lë përshtypjen që Kuvendi ka diskrecion për të vendosur nëse do ta shkarkojë Presidentin e gjetur në shkelje të rëndë të Kushtetutës me vendim të Gjykatës. Kjo, megjithatë, nuk është kështu. ne nenin 116.1 qartë përcaktohet se vendimet e Gjykatës janë të detyrueshme për të gjithë.[213] Në fakt, çdo interpretim ndryshe i kësaj çështje do të ishte në kundërshtim me vetë natyrën e gjyqësisë kushtetuese, si një aktivitet shtetëror që synon sigurimin e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës, jo të vendimeve të organeve tjera kushtetuese. Thënë me fjalë tjera, sikur të merrej që Kuvendi ka diskrecion për të vendosur lidhur me këtë, atëherë do të dilte sikur gjyqësia kushtetues ka për qëllim sigurimin e supremacisë (epërsisë) së vullnetit të organit përfaqësues dhe legjislativ, jo të Kushtetutës. Kjo nuk do të ishte demokraci kushtetuese, por demokraci popullore. Kjo, përfundimisht, nënkupton që neni 91.3, në ndërlidhje me nenin 113.6 dhe nenin 116.1, përcakton detyrimin e Kuvendit që të votojë **pro** vendimin të

---

211 Ibid., paragrafi 32:
"Në rastin e **Presidentit Sejdiu**, është e nevojshme që të shohim **situatën faktike** për të parë nëse mbajtja e funksionit të **Kryetarit të LDK**-së, por "ngrirja e atij pozicioni", ishte një rast i vetëm, i cili ndodhi njëherë të vetme ose nëse përben një situatë që vazhdon çdo ditë. Nëse është kjo e fundit, atëherë nuk ekziston afat kohor më të cilin deputetët duhet të parashtrojnë një kërkesë pranë Gjykatës në lidhje me shkeljen e supozuar. Për më tepër, fakti i "mbajtjes dhe ngrirjes" së pozicionit, duket se implikon që ngrirja e këtij pozicioni mbetet në fuqi gjatë gjithë kohës. Presidenti pranon se ai ka vazhduar të jete **Kryetari i LDK**-se dhe **Presidenti i Republikes** çdo dite qe nga zgjedhja e tij në 2006".

212 Neni 91.3 ["Shkarkimi i Presidentit"] i Kushtetutës. "[…] 3. Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës është dënuar për ndonjë krim të rëndë ose kur nëse Kuvendi, në pajtim me këtë nen, konstaton që Presidenti nuk është i aftë të ushtrojë përgjegjësitë e tij/saj për shkak të sëmundjes së rëndë ose **nëse Gjykata Kushtetuese konstaton se ajo/ai ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës, Kuvendi mund të shkarkojë Presidentin me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij.** "[…].

213 Neni 116. 1 ["Efekti Juridik i Vendimeve"] i Kushtetutës. 1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës. […]"

Gjykatës që konstaton **shkelje serioze kushtetuese** nga ana e **Presidentit të Republikës**, veprim që nuk mund të rikthehet apo sanksionohet nga ana e Kuvendit. Në këtë procedurë votimi, Kuvendi vepron thjeshtë si një shpallës i vendimit të Gjykatës, dhe nuk ka autoritet që ta refuzojë vendimin e tillë. Në të kundërtën, përcaktimi i nenit 116.1 të Kushtetutës do të shkelej, duke marrë parasysh gjithashtu që, sipas nenit 113.6, Gjykata nuk vepron në juridiksion **opiniondhënës**, por nën një juridiksion **represiv**. Me një fjalë, nëse në nenin 116.1 përcaktohet se vendimet e Gjykatës janë të detyrueshme për të gjithë, atëherë nuk ka ndonjë arsye që t'i lejohet Kuvendit për të vendosur nëse do të zbatojë vendimin e Gjykatës në të cilën konstatohej shkelja serioze Kushtetutës.

Për këtë arsye, vendimi i Kuvendit sipas nenit 91.3 për shkarkim të Presidentit me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij duhet kuptuar si vendim që ka natyrë deklarative, jo konstitutive. Përveç këtij argumenti, fakti se Gjykata nuk ka **juridiksion këshilldhënës**, siç kanë disa gjykata (ta zëmë, ajo bullgare, italiane, etj.)[214] flet në favor të asaj që Kuvendi nuk ka diskrecion për të vendosur lidhur me fatin e aktgjykimit të Gjykatës me të cilin konstatohet shkelja serioze e Kushtetutës nga Presidenti. Juridiksioni nga ky nen, në këtë kontekst, duhet të nënkuptohet si sanksion kushtetues për Presidentin e Republikës në rastet kur ai/ajo bën shkelje serioze, të rënda, të Kushtetutës. Kjo është kështu, fundja, nëse kihet parasysh fakti se Presidenti është i vetmi institucion që ka sanksion kushtetues që mund të zbatohet në mënyrë efektive ndaj tij/saj.[215] Në përgjithësi, prandaj, Gjykata vishet me një juridiksion shumë të fuqishëm përballë Presidentit të Republikës, juridiksion që faktikisht e bën Gjykatën të ushtrojë rolin e një kundërbalancuesi të pavarur të institucionit në fjalë, institucion që edhe vetë sipas neneve 4.3 ["Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit"], 83 ["Statusi i Presidentit"] dhe 84.1 ["Kompetencat e Presidentit"] të Kushtetutës supozohet se është balancues i tri pushteteve të tjera.

Fare në fund duhet thënë se kjo dispozitë e Kushtetutës, e cila vendimin e Gjykatës e referon në Kuvend për vendim përfundimtar përbën cenim të teorisë dhe praktikës mbi gjyqësinë kushtetuese. Kjo është e vetmja dispozitë në Kushtetutë që e bën një gjë të tillë, pra që një organi tjetër kushtetues i jep autorizim për të pasur ndikim në fatin përfundimtar të vendimeve meritore të Gjykatës. Si e tillë është shumë e rrallë në gjyqësinë kushtetuese komparative: ka ekzistuar vetëm në **Rumani** për një kohë dhe më nuk ekziston.[216] Është kundër natyrës së gjyqësisë kushtetuese sepse vendimet meritore të gjykatës kushtetuese supozohet se çdoherë

---

214 Cf. Herman Schwartz, *The Struggle for Constitutional Justice in Post – Communist Europe*, fq. 164-193; Giancarlo Rola and Tania Groppi, "Between Politics and the Law: The Development of Constitutional Review in Italy." Në Wojciech Sadurski (ed), *Constitutional Justice, East and West*, fq. 143-159.

215 Rasti **KO 47/10**, aktgjykim, paragrafi 31.

216 **Gjykata Kushtetuese e Rumanisë**, deri në ndryshimet kushtetuese të vitit 2003, ka ruajtur disa relikte nga përvoja e para **Luftës së Dytë Botërore** sa i përket supremacisë (epërsisë) së Parlamentit: në fillim, më 1991, u fut zgjidhja që Parlamenti mund të rrëzonte me një shumicë të kualifikuar prej dy të tretave çdo vendim të **Gjykatës Kushtetuese** me të cilin konstatohej një shkelje kushtetuese. Kjo i jepte mundësi kushtetuese Parlamentit që të rrëzojë, përktësisht të konvalidojë (të shërojë) çdo ligj apo veprim tjetër të një autoriteti publik të shpallur si jokushtetues nga Gjykata me një shumicë të kualfikuar prej dy të tretave (2/3) të votave parlamentare. Ngjashëm me këtë sot ekziston zgjidhja kushtetuese që ka të bëj me propozimin për suspendim nga detyra të shefit të shtetit rumun. Në këtë proces, **Gjykata Kushtetuese e Rumanisë** dhe **Parlamenti** kanë detyrat e ndara. Gjykata në këtë mes jep mendim këshidhënës, kurse Parlamenti vendosë për suspendimin e shefit të shtetit. Me amendamentet e vitit 2003, megjithatë, Parlamenti nuk ka supremaci (epërsi) për fatin e shefit të shtetit sepse verdikti merret nga sovrani përmes referendumit ashtu që vetë sovrani vendos për shkarkimin përfundimtar të shefit rumun të shtetit, i cili është suspenduar me vendim të Parlamentit dhe me mendimin këshilldhënës të Gjykatës. Kjo do të thotë se Parlamenti ka të drejtën e propozimit për shkarkim, duke e supsenduar dhe duke e vënë ushtruesin e detyrës së shefit të shtetit, i cili vendim pastaj shkon për kontroll kushtetues në Gjykatën Kushtetuese, e cila nga ana e saj e jep një mendimin këshilldhënës dhe, në fund, tërë ky proces votohet në referendum. Kjo do të thotë se këtu Gjykata ka rol këshilldhënës dhe sovrani është ai që ka epërsi kundrejt Kushtetutës, jo **Parlamenti i Rumanisë**, sepse mendimi këshilldhënës i Gjykatës nuk mund të votohet në Parlament. së bashku me vendimin e këtij të fundit, mendimi këshilldhënës i Gjykatës shkon për votim në referendum të sovranit. Edhe kjo zgjidhje kushtetuese aktuale në **Rumani** nuk i shkon aq shumë gjyqësisë kushtetuese, natyrës së saj të një gjyqësie që ka për mision primar sigurimin e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës, jo të vullnetit të drejtpërdrejtë të sovranit. Rastin rumun, krahas rasteve tjera të ish-vendeve komuniste i kemi diskutuar gjerësisht në kapitullin e pestë të këtij libri.

duhet të jenë përfundimtare, të formës së prerë dhe të ekzekutueshme. Dispozita si më sipër e nenit 116.1 të Kushtetutës nuk është asgjë tjetër pos përshkrim i natyrshëm i fizionomisë themelore të gjyqësisë kushtetuese të modelit **evropian/kelsenian** që kultivohet në Kosovë.

11.3.7. Juridiksioni nga neni 113. 7 i Kushtetutës si një juridiksion konkret dhe derivativ në lëmin e lirive dhe të drejtave kushtetuese: ankesa kushtetuese

Përveç juridiksionit abstrakt, përmes së cilit Gjykata bën kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së akteve juridike, kontroll që bëhet sipas aktorëve të privilegjuar institucionalë sipas neneve të diskutuara më sipër, neni 113.7 i Kushtetutës u jep autorizim individëve për të iniciuar shkeljet e të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese të kryera nga autoritetet publike, por vetëm pasi që të kenë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Kërkesa, sipas nenit 49 të **Ligjit Nr. 03/L-121**, paraqitet në afatin prej katër muajve nga dita e marrjes së vendimit gjyqësor, shpalljes publike të vendimit apo hyrjes në fuqi të ligjit që kontestohet.[217] Ky juridiksion përbën hapësirën e vetme ku Kushtetuta i autorizon individët që të iniciojnë një procedurë të kontrollit kushtetues të kushtetutshmërisë së akteve individuale të autoriteteve publike, përfshirë gjykatat, të dhëna në një rast konkret. Kjo do të thotë se termi shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive individuale që përdorë ky nen, ka të bëjë me vendime dhe veprime të organeve publike të mandatuara me kushtetutë për vendosje në vijim zbatimit të kushtetutës, ligjit dhe akteve tjera të përgjithshme lidhur me një rast apo mosmarrëveshje konkrete. Juridiksioni i Gjykatës në këtë rast ka të bëjë me ushtrimit të kontrollit kushtetues të tipit individual dhe konkret. Thënë me fjalë tjera, ky juridiksionin i Gjykatës ka të bëjë me ushtrimin e kontrollit të kushtetutshmërisë së vendimeve dhe veprimeve të organeve publike, të dhëna në raste individuale, të ngritura sipas kërkesës së individëve. Kjo procedurë përbën mekanizmin e vetëm juridiksional ku Gjykata kontrollon kushtetutshmërinë e akteve individuale të autoriteteve publike, përkatësisht kontrollon nëse ato akte individuale cenojnë të drejtat dhe liritë individuale të përcaktuara me kushtetutë.[218] Ka pasur autorë që kanë shkuar aq larg sa të thonë se ky juridiksion përbën legjitimimin e vetëm për të cilin edhe duhet të ekzistojë kontrolli kushtetues.[219] Kjo, megjithatë, nuk mund të jetë e sakët sepse shkon kundër vetë natyrës së gjyqësisë kushtetues, historikisht shikuar, që identifikohet me kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë e vetëm pastaj me këtë lloj të kontrollit kushtetues që ka për fokus mbrojtjen përmes gjyqësisë kushtetuese të pozitës së individit në shoqëri. Kjo është kështu sepse, tek e fundit, përmes këtij juridiksioni, gjykatat kushtetuese bëhen gjykatës të gjyqtarëve të rregullt, duke tejkaluar kështu kufirin tradicional të gjyqësisë kushtetuese të vendosur nga **Hans Kelzen**. Autorët tjerë kanë qenë, në vijim të këtij konteksti, më të arsyeshëm, duke parë në këtë juridiksion një

---

217 Neni 49 [“Afatet”] i **Ligjit Nr. 03/L-121**: “Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.

218 Kështu është edhe në **Shqipëri**, por edhe në shumicën e vendeve tjera që modelohen sipas sistemit **evropian/kelsenian**. **Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë** ka jurdiksion për t’i ekzaminuar kërkesat e dorëzuara nga personat fizikë dhe ata juridikë që pretendojnë shkelje të të drejtave të tyre themelore nga vendime të paligjshme. Termi **vendim** siç përdoret në ligjin themelor nuk mbulon vetëm vendimet e organeve tjera shtetërore, por edhe ato të gjykatave të rregullta. (**vendim i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë** nr. 57 i datës 04.11.1998); Për vendet tjera në katër anët e botës, përfshirë vendet ish komuniste, cf. materialin e Komisionit të Venecias mbi qasjen individuale në gjyqësinë kushtetuese, në EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION), “Study on Individual Access to Constitutional Justice”.Adopted by the Venice Commission at its 85th Plenary Session (Venice, 17-18 December 2010) *Study N° 538 / 2009 CDL-AD(2010)039rev. Original English* (Strasbourg, 27 January 2011). Në internet: http://www. venice.coe.int/ Web Forms/ documents/ default. aspx? pdffile=CDL-AD(2010)039rev-e (shikuar në shkurt 2019).

219 Christopher Wolfe, *The Rise of Modern Judicial Review: From Constitutional Interpretation to Judge-Made Law.* (Roëman & Littlefield Publishers: London, 2004) fq. 337.

mekanizëm përmes së cilit garantohet pozita më e lartë hierarkike për të drejtat e njeriut në rendin e brendshëm juridik.[220]

Në jurisprudencën komparative, ky juridiksion mund të përfshijë dy grupe të situatave në të cilat vjen deri kundërkushtetutshmëria e aktit, e shkaktuar apo që mund t'i atribuohet autoriteteve publike, dhe që ka të bëjë me cenimin e lirive dhe të drejtave kushtetuese:

- situatat e para janë kur akti individual apo veprimi është si i tillë kundërkushtetues (shkelje e menjëhershme e kushtetutës e shkaktuar nga organi apo që mund t'i atribuohet organit); dhe,
- situatat e dyta janë kur një akt individual apo veprim i një organi që ushtron autorizime publike të bazuara në kushtetutë bazohet në një ligj, i cili për çfarëdo arsye është kundërkushtetues (shkelja derivative e kushtetutës e shkaktuar nga organi apo që mund t'i atribuohet organit).[221]

Këto dy aspekte të kundërkushtetutshmërisë të marra së bashku përbëjnë thelbin e **kërkesës së plotë kushtetuese** ("**echte**"), e cila burimin e ka në të **jurisprudencën gjermane** dhe sipas të cilës me shumë gjasë modelohet dispozita e nenit 113.7 e që e diskutojmë këtu. Këtë e kemi konstatuar në kapitujt pararendës të këtij libri. Të rralla janë vendet që njohin **kërkesën e plotë kushtetuese**: shumica e shteteve e njohin vetëm **kërkesën jo të plotë kushtetuese** (**unechte**). Kjo e fundit nënkupton atë lloj të kërkesës ku individët dhe personat juridikë mund ta vejnë në lëvizje gjykatën kushtetuese vetëm sa i përket aspekteve juridike të kërkesës individuale, kurse aspektet tjera të kundërkushtetutshmërisë lihen të paprekura dhe mund të sanohen në procedurë të veçantë pasi të jetë konstatuar jokushtetutshmëria e aktit të përgjithshëm mbi të cilin bazohet vendimmarrja në një rast konkret individual. Për këtë arsye, **ankesa jo e plotë** nuk konsiderohet si mjet efektiv juridik në jurisprudencën e **GJEDNJ**, pra për shkak se nuk mund të riparojë cenimet (shkeljet) e të drejtave dhe lirive kushtetuese të shkaktuara ndaj një individi meqë rrënja e kundërkushtetutshmërisë është një akt i përgjithshëm që është zbatuar në një rast konkret individual.

Në rastin kosovar, çështja e parë që duhet konsideruar në lidhje me juridiksionin nga neni 113.7 është subjekti i autorizuar për të ngritur para Gjykatës këtë kontroll kushtetues. Ky paragraf përcakton që **individët** janë e vetmja palë e autorizuar për ta vënë në lëvizje këtë juridiksion. Koncepti individ, megjithatë, i shfrytëzuar në këtë dispozitë kushtetuese, duhet dekonstruktuar në mënyrë që të përcaktohet nëse ai përfshin vetëm personat fizikë apo edhe ata juridikë. Në rastin **Universiteti AAB ShPK v. Qeveria e Republikës së Kosovës**,[222]

---

[220] Kështu, ta zëmë, modeli i gjyqësisë kushtetuese franceze nuk lejon hapësirë për një lloj të tillë të juridiksionit: Louis M. Aucoin, (1992) "Judicial Review in France: Access of the Individual Under French and European Community Law in the Aftermath of France's Rejection of Bicentennial Reform". *Boston College International and Comparatve Law Review*. Vol. 15 Issue 2 (1992) fq. 443-469, në fq. 443. Kjo gjendje, megjithatë, ka ndryshuar në njëfarë mase pas marsit të vitit 2010, kur në **Francë** hyri në fuqi reforma kushtetuese. Tani atje lejohet që individët të sfidojnë në kuadër të procedurave të **kontrollit incidental** ligjet, të cilat cenojnë të drejtat dhe liritë themelore kushtetuese. Kjo procedurë në **Francë** njihet me emërin **la *question prioritaire de constitutionnalité* (*QPC*).** Cf. Bertrand Mathieu, "Le Conceil Constitutionel "legislateur positif". Ou la question des interventions du judge constitutionnel francais dan l' exercise de la fonction legislative". Në Allain R. Breëer-Carias (ed.), *Constitutional Courts as Postive Legislators. A Comparative Law Study*, fq. 471-495, në fq. 476-477; Sophie Boyron, "France". Në Dawn Oliver and Carlo Fusaro (eds.), *How Constitutions Change. A Comparative Study.* (Hart Publishing. Oxford and Portland, Oregon, 2011) fq. 115-142, në fq. 139-142; Michael Verpeaux, La Question Prioritaire de Constitutionnalite (Hachette: Paris, 2013) (ku autori flet për rrënjët e këtij institutio të ri në Francë, origjinën e tij dhe shkaqet e lendjes së tij së fundi, si dhe historikun e kontrollit kushtetues frnacez që nga fillimi); Louis Favoreu & Wanda Mastor, *Les cours constituionnelles* 2[e] edition (Dalloz: Paris, 2016) fq. 23-24, 30-32, 70, 99 & 125.

[221] Helmut Steinberger, "Models of Constitutional Jurisdiction", pika IV, paragrafi 10.

[222] Cf. *Rasti KI 41/09. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues. Universiteti AAB – RIINVEST L.L.C, Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. Ref.: RK 04/10). Prishtinë. Datë: 27 janar 2010. Paragrafi 14.

Gjykata ka përcaktuar që koncepti individ në kuptim të kësaj dispozite përfshin jo vetëm personat fizikë, por edhe ata juridikë: për aq sa është e mundur që personat juridikë të gëzojnë të drejtat dhe liritë e garantuara me kushtetutë dhe janë të autorizuar që të ngrenë kontrollin kushtetues sipas këtij neni kushtetues. Kjo është derivativ i dispozitës së nenit 21.4 të Kushtetutës që flet për parimet e përgjithshme në sferën e të drejtave dhe lirive të njeriut.[223]

Çështja e dytë që duhet konsideruar në kuptim të këtij juridiksioni, është koncepti i shterjes së mjeteve juridike përpara se çështja të bëhet proceduralisht legjitime për tu ngritur para Gjykatës Kushtetuese. Në kuptim të juridiksionit sipas këtij paragrafi, personat mund të ngrenë çështje **vetëm pasi të kenë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj**. Në të kundërtën, çështja nuk lejohet që të ngrihet dhe, nëse ngrehet, në Gjykatë shpallet i papranueshëm sepse konsiderohet që **pala ka hequr dorë** nga e drejta për të ndjekur më tutje rastin me qëllim të realizimit të të drejtave të saj/tij kushtetuese.[224] I rëndësishëm në komentimin e konceptit të **shterjes së mjeteve juridike** është precedenti gjyqësor i **GJEDNJ**-së, i cili është shumë i pasur me standarde në këtë fushë (kjo gjykatë e merr këtë fjali në kuptim të shterjes së **mjeteve nacionale juridike**). Diskutimi ynë bazohet pikërisht në këtë precedent, siç bazohet çdo vendim i **Gjykatës Kushtetuese** kur gjykon në bazë të këtij neni. Ky është një obligim kushtetues që stipulohet në nenin 53 ["Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut"] të Kushtetutës, i cili thotë. "Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".

Esenca e arsyetimeve të Gjykatës, që theksojnë shterjen e mjeteve juridike përpara se çështja të adresohet tek ajo, ka të bëjë me argumentin që në vazhdimësi e përdor **GJEDNJ** e që thotë se, së pari, duhet lejuar që gjykatat e rregullta, por edhe institucionet shtetërore në përgjithësi, ta korrektojnë shkeljen e supozuar.[225]

---

223 Neni 21 ["Parimet e Përgjithshme"] i kapitullit II ["Të Drejtat dhe Liritë Themelore"] të Kushtetutës:
"1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.
2. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.
3. Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.
4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, **vlejnë edhe për personat juridikë**, për aq sa janë të zbatueshme"

224 *Rasti KI 107/16. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Safet Muhaxheri dhe te tjerët. Vlerësim i kushtetutshmërisë se Aktgjykimit te Kolegjit të Specializuar te Dhomës se Posaçme te Gjykatës Supreme te Kosovës për çështje qe lidhen me Agjencinë Kosovare te Privatizimi*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Nr. ref.: RK 1108/17. Prishtinë, më 24 korrik 2017. Këtë rast e citojmë si një shembull tipik të kësaj qasje të Gjykatës, duke shmangur citimin e vendimet tjera që janë një dyzinë dhe që ripërsërisin këtë formulim që thuhet në dy paragrafët e këtij vendimi, të cilat citohen të plotë në vijim:
"[…] 25. Në rastin konkret, Gjykata konkludon se parashtruesit e kërkesës kane pasur ne dispozicion dy mjete juridike para gjykatave te rregullta, te cilat ishin ne dispozicion dhe te cilat kane mundur te korrigjojnë shkeljet në lidhje me kundërshtimet e parashtruesve të kërkesës, por që këto mjete efektive juridike parashtruesit e kërkesës nuk i kane shteruar.
26. Kështu, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës kane hequr dorë nga e drejta e tyre për ankesë të mëtejshme dhe kështu nuk i kanë shterur të gjitha mjetet juridike te parapara me ligj. Cf. *Rasti KO 07/09. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Deme KURBOGAJ dhe Besnik KURBOGAJ kundër Aktgjykimit te Gjykatës Supreme Pkl.nr. 61/07 të 24 nëntorit 2008, Aktgjykimit te Gjykatës Supreme Nr. Ap.nr. 510/2007 të 26 marsit 2008.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Ref. nr.: AGJ21/10. Prishtinë, më dt. 19 maj 2010. Paragrafët 28-29.

225 Cf. *Rasti KI 22/11. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues. Bojana Denić. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, A. Nr. 263/2010, të 12 nëntorit 2010.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Ref. No.: RK 124/11. Prishtinë. Datë: 19 maj 2011. Këtë rast e citojmë si një shembull tipik të kësaj qasje të Gjykatës, duke shmangur citimin e vendimet tjera që janë një dyzinë dhe që ripërsërisin këtë formulim që thuhet në dy paragrafët e këtij vendimi, të cilat citohen të plotë në vijim:
"28. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për shterimin e mjeteve juridike është që t'ua lejojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë një mjet efikas juridik për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, **mutatis mutandis**, GJEDNJ, **Selmouni kundër Francës**, Nr. 25803/94, Vendim i 28 korrikut 1999). Megjithatë, nuk është e nevojshme që të drejtat kushtetuese të ceken në mënyrë eksplicite në procedurën në fjalë. Nëse çështja ishte ngritur në mënyrë implicite ose në substancë, rregulli i shterimit të mjeteve juridike është plotësuar (shih, **mutatis mutandis**, GJEDNJ, **Azinas kundër Qipros**, Nr. 56679/00, Vendim i 28 prillit 2004).
29. Duke pasur këtë parasysh, është e qartë se në bazë të dokumentacionit të parashtruar Gjykatës nuk i janë paraqitur dëshmi që parashtruesja i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion të parapara me ligj në përpjekjen e saj që kërkesa t'i miratohet nga Gjykata. Rrjedhimisht, ajo nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj për të parashtruar kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës".

Kjo sepse supozohet se organet dhe institucionet tjera i kryejnë autorizimet e tyre kushtetuese dhe ligjore në mënyrë të duhur dhe sipas kushtetutës e ligjit. Nëse kjo nuk funksionon, atëherë hyn në terren juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese si një gjykatë subsidiare. Kjo nënkupton se Gjykata asnjëherë nuk substituohet në vend të gjykatave të rregullta apo institucioneve dhe organeve tjera shtetërore. Me shterje të mjeteve juridike duhet nënkuptuar jo vetëm mjetet juridike në kuptim formal, siç janë ankesa, revizioni, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, etj., por edhe mjetet juridike në kuptim të shterjes së mundësisë, por pa sukses, për të paraqitur kërkesat e ndryshme në procedurat e rregullta ligjore para gjykatave dhe organeve tjera. Kjo nënkupton se parashtruesi i kërkesës individuale pranë Gjykatës nuk do të ketë sukses në realizimin e kërkesës së vet nëse e njëjta kërkesë nuk është paraqitur (ngritur) me kohë në procedurat e rregullta ligjore para gjykatave dhe organeve tjera. Nuk është e domosdoshme që të drejtat kushtetuese të ngrihen në mënyrë eksplicite në procedurat e rregullta ligjore para gjykatave dhe organeve tjera.[226] Ky quhet **efekti prekluziv** i mosrespektimit të rregullës për shterjen e të gjitha mjeteve (efektive) juridike para paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore.

Në konsiderimin e shterjes së mjeteve juridike, Gjykata mbështetet fort në jurisprudencën e **GJEDNJ**. Në këtë kuptim, **Strasburgu** ka krijuar precedente stabile dhe formulime standarde që në jurisprudencën kosovare vetëm përsëriten duke i përshtatur për rrethanat e secilit rast konkret. Kjo mundësi, e krijuar përmes dispozitës kushtetues nga neni 53 ["Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut"] i Kushtetutës, ka qenë mjaft pozitive për **Gjykatën Kushtetuese të Republikës**, marrë parasysh faktin se ka qenë një gjykatë e re dhe pa ndonjë përvojë në gjyqësinë kushtetuese moderne, në veçanti pa asnjë përvojë në lëmin e juridiksionit që ka të bëjë me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave e lirive njerëzore përmes mekanizmit të gjyqësisë kushtetuese. Të shohim tani si duken këto terme dhe standarde të krijuara në jurisprudencën e **GJEDNJ.**

Kjo gjykatë, në rend të parë, lidhur me shterjen e mjeteve juridike, kërkon që aplikimi i rregullës të bëhet me **fleksibilitet** dhe **pa shumë formalitet**, siç ka bërë, ta zëmë, në **Kenneth LEHTINEN v. Finland**.[227] Në **Van Oosterwijck v. Belgium**,[228] **GJEDNJ** ka shkuar tutje dhe ka përcaktuar që rregulla mbi shterjen e mjeteve juridike nuk është as **absolute** dhe as **automatike,** gjë që nënkupton se shterja e mjeteve juridike duhet shikuar në kuptim të rrethanave reale të parashtruesit të kërkesës. Në **Akdivar et al v. Turkey**,[229] ajo ka specifikuar tutje këtë rrethanë kur ka përcaktuar që në vlerësimin e shterjes së mjeteve juridike nga ana e parashtruesit duhet vlerësuar jo thjeshtë aspekti formal i sistemit të mjeteve juridike, por edhe rrethanat e përgjithshme, sistemi juridik dhe politik në të cilin ka pasur akses parashtruesi, si dhe kontekstin personal të tij. Këto qasje të **GJEDNJ**-së, të marra së bashku, kërkojnë që mjeti juridik të jetë si i **mundshëm** ashtu edhe **efektiv,** meqë, siç është thënë në **D. H. et al. v. The Czech Republic**,[230] kërkohet të konstatohet nëse parashtruesi i ka shfrytëzuar mjetet që janë pritur se do të shfrytëzohen nga parashtruesi. Kjo është kështu sepse mund të ketë rrethana të tilla në të cilat, shfrytëzimi i mjetit juridik nga ana e aplikantit do ta vendoste atë në rrethana rreziku. Në raste të tilla rreziku dhe vështirësish të pakapërcyeshme

---

226 *Rasti KI 21/09. Vendim. Parashtrues: Agim Kryeziu kundër Komunës së Prizrenit*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Ref. nr.:RK15110. Prishtine. Datë: 11 Maj 2010. Parag. 16. "[…] 16. Edhe nëse çështja është ngritur në mënyrë implicite apo në substancë, kushti i shterjes së mjeteve do te jetë përmbushur (shih, **mutatis mutandis**, ECtHR, **Azinas kunder Qipros**, nr. *56679/00,* vendim i dates 28 prill 2004)." Edhe këtë rast e citojmë si një shembull tipik të kësaj qasje të Gjykatës, duke shmangur citimin e vendimet tjera që janë një dyzinë dhe që ripërsërisin këtë formulim që thuhet në këtë paragraf.

227 **Kenneth LEHTINEN v. Finland**, Application no. 39076/97, Decision as to Admissibility, Chamber of ECtHR (referring to the **Cardot v. France judgment** of 19 March 1991, Series A no. 200, 18, para. 34);

228 **Van Oosterwijck v. Belgium**. Judgment of 6 November 1980, ECtHR Series A no. 40, para. 35, 18.

229 **Akdivar and Others v. Turkey**. ECtHR, Judgment of 16 September 1996, Reports of Judgments and Decisions 1996-IV, p. 1210-1211,paras. 65-68;

230 **D. H. et al. v. The Czech Republic**, Application no. 57325/00, Judgement, Grand Chamber, ECtHR, 13 November 2007, para. 116 (referring to İlhan v. Turkey [GC], no. 22277/93, para. 59, 2000-VII);

për parashtruesin mund ta aplikohet parimi që thotë se parashtruesi nuk ka pasur qasje në mjet juridik **të mundshëm dhe efektiv**, duke ia pranuar të njëjtit parashtresën pa i shterur mjetet juridike.[231]

Qasja fleksibile ndaj shterjes së mjeteve juridike është shfrytëzuar nga Gjykata Kushtetuese, ta zëmë, në rastin **Tomë Krasniqi v. RTK et al**.,[232] kur për shkak të faktit që parashtruesi nuk mund të atakonte në gjyqësorin e rregullt një akt juridik të përgjithshëm në mënyrë direkte, Gjykata u detyrua që të vlerësojë **shkeljen e supozuar direkte nga akti i përgjithshëm** pa u shterur mjetet juridike në gjyqësorin e rregullt kosovar. E njëjtë ishte qasja edhe në **Valon Bislimi v. Ministria e Punëve të Brendshme et al**, ku Gjykata, për shkak që konstatoi që parashtruesi nuk kishe qasje në një mjet juridik efektiv, i lejoi shfrytëzimin e këtij juridiksioni edhe pa shterur ndonjë mjete juridik: në këtë rast, parashtruesi argumentoi që, për shkak se ishte objekt i një shkeljeje të së drejtës së tij kushtetues nga një **mosveprim** i shkaktuar përmes **heshtjes administrative** të Ministrisë së Brendshme, ai nuk kishte mundësi që aktin e **mosveprimit** ta ankimonte në sistemin e rregullt gjyqësor. Prandaj, Gjykata ia pranoi kërkesën si të pranueshme, me arsyetimin që parashtruesi nuk i ishte dhënë mundësia në qasje në mjete efektive juridike të **pritshme** dhe të **mundshme**.[233]

Një kusht tjetër që kërkohet sipas nenit 113.7 është që parashtruesi, në mënyrë që të autorizohet për të shfrytëzuar juridiksionin përkatës të Gjykatës, duhet që të jetë **prekur** nga një **shkelje** e një institucioni publik të shtetit. Më një fjalë, parashtruesi mund të iniciojë çështje individuale pranë Gjykatës vetëm nëse ka interes të drejtpërdrejtë në të**. Interesi i drejtpërdrejtë** në çështje, sipas standardit të vënë nga **GJEDNJ**, konsiderohet të ekzistojë atëherë kur parashtruesi është **viktimë** e një shkeljeje të një autoriteti publik. Kjo ka për pasojë që, siç ka përcaktuar **GJEDNJ** në **Scordino v. Italy**,[234] parashtruesi duhet të **dëshmojë** se është viktimë e një shkeljeje të së drejtës së tij kushtetuese, në mënyrë që të mund të hyjë nën tutelën e këtij juridiksioni. Vlerësimi nëse një palë është viktimë e një akti të një institucioni publik, megjithatë, duhet të bëhet në mënyrë të arsyeshme dhe liberale, në përputhje me gjendjen politike dhe rrethanat në shtetin ku është bërë shkelja e të drejtës së parashtruesit. Kështu është thënë nga GJEDNJ në **Gorraiz Lizarraga et al. v. Spain**.[235] Jo vetëm kaq! Parashtruesi, sipas **GJEDNJ**-së në **Amuur v. France**,[236] duhet që të ketë qenë **viktimë direkte** e një shkelje të supozuar, në të kundërtën, nuk mund që të jetë palë me legjitimitet aktiv sipas nenit 113.7. U mor vesh, përcaktimi i **viktimës së drejtpërdrejtë** duhet të bëhet në një mënyrë jo të ngurtë, siç është thënë nga **GJEDNJ** në **Karner v. Austria,**[237] duke lënë mundësinë që nëse viktima e drejtpërdrejtë nuk ka mundësi shfrytëzimi të këtij juridiksioni, këtë ta bëjë viktima indirekte. Për mundësinë që viktima indirekte të jetë palë me legjitimitet aktiv u konstatua në **McCann et al. v. The United Kingdom**).[238] GjEDNj ka shkuar më larg se kaq në **Vijayanathan & Pusparajah v. France**,[239] kur ka argumentuar që edhe vet bindja apo supozimi i parashtruesit që është viktimë e arsyeshme e një akti publik duhet që të vlerësohet nga ana e Gjykatës si një rrethanë e mjaftueshme për ta shfrytëzuar juridiksionin përkatës.

---

231 Cf., ta zëmë, Elke Luise Barnstedt, "Differences Between Constitutional Complaints That Challenge Court Rulings And Those That Challenge Statutes". Në European Commission For Democracy Through Law (Venicee Commission), **Fourth Conference of Secretaries General of Constitutional Courts and Courts of Equivalent Jurisdiction,** Ankara, Turkey, 1-2 October 2009. **Venice Commission**. *CDL-JU(2009)055* fq. 2.

232 *Rasti KI 11/09. Vendim. Masë e Përkohshme (MP) në Rastuin KI 11/09. Tome Krasniqi kundër RTK et Al.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. Ref.: MP 01/09. Datë: 16 tetor 2009.;

233 *Rasti 06/10.Aktgjykim. Parashtrues: Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. Ref.: AGJ 63/10. Datë: 30 tetor 2010. Paragrafi nr. 60.

234 **Scordino v. Italy** (no. 1), Application no. 36813/97, Judgement, Grand Chamber, ECtHR, 29 March 2006 (para. 179);

235 **Gorraiz Lizarraga et al. v. Spain**, ECtHR, Application no. 62543/00, Judgement, Chamber, 27 April 2004 (para. 38);

236 **Amuur v. France**, 17/1995/523/609, Judgement, Chamber, ECtHR, 25 June 1996 (para. 36);

237 **Karner v. Austria**, Application no. 40016/98, Judgement, Chamber, ECtHR, 24 July 2003 (para. 25);

238 **McCann et al. v. The United Kingdom**, Application no. 18984/91, Judgement, Grand Chamber, ECtHR, 27 September 1995;

239 **Vijayanathan & Pusparajah v. France,** ECtHR, Application no. 17550/90; 17825/91, Judgement, Chamber, 27 August 1992 (para. 46);

E rëndësishme sa i përket juridiksionit sipas nenit 113.7 është edhe gjerësia dhe natyra e veprimit të këtij juridiksioni. Ky juridiksion është i tipit **ex post,** meqë mekanizmi i kontrollit kushtetues të një shkeljeje të supozuar individuale vihet në veprim vetëm pasi që pala të ketë **absorbuar** një pasojë që supozohet që i shkel asaj një të drejtë kushtetuese.[240] Absorbimi nënkupton që, për shfrytëzimin me sukses të këtij juridiksioni, në të kaluarën duhet ketë ndodhur një situatë kundërkushtetuese, e cila situatë mbulohet me një akt të një autoriteti publik. Akti i tillë i autoritetit publik goditet nga parashtruesi me ankesë kushtetuese me kërkesë që Gjykata të bëjë vlerësimin e kushtetutshmërisë së tij, përkatësisht me pohimin se akti i tillë ka cenuar liritë dhe të drejtat e saj/tij kushtetuese. Në kuptim të caqeve të këtij juridiksioni, sikundër shihet, Gjykata është e autorizuar që të kontrollojë **vetëm** kushtetutshmërinë e një akti të një autoriteti publik sa i përket të drejtave të njeriut dhe lirive njerëzore të garantuara me Kushtetutë. Kjo nënkupton që, **argumentum a contrario**, se ai autoritet publik duhet të jetë i Republikës së Kosovës, jo i ndonjë vendi tjetër të huaj dhe sovran.[241] Sa i përket cenimeve kushtetuese të kryera me aktin a një autoriteti publik kosovar, një gjë e tillë përfshin të gjitha të drejtat e garantuara me kushtetutë, si ato procedurale (ta zëmë, e drejta në gjykim të drejtë) ashtu edhe ato substanciale (ta zëmë, e drejtë në pronë ose e drejta në arsim), pa marrë parasysh origjinën e shkeljes së kushtetuese të përmbajtur në aktin juridik të autoritetit publik. Kjo është sepse objekt i kontrollit kushtetues në këtë procedurë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktit juridik individual të një autoriteti publik që është dhënë (nxjerrë, miratuar) në vijim të ushtrimit të autorizimeve të njohura kushtetuese. Me rëndësi është që akti të jetë individual, i dhënë (nxjerrë, shqiptuar, miratuar) në një procedurë të zbatimit të një norme të përgjithshme në një rast apo mosmarrëveshje konkrete. U mor vesh, akti i tillë duhet të jetë i formës së prerë dhe që pala mos të ketë mundësi tjera që të kërkojë korrigjimin e shkeljeve të të drejtave dhe lirive të saj kushtetuese pos pranë Gjykatës Kushtetuese (shterja e mjeteve juridike). Për shkak të kushtit kushtetues që pala mund t'i drejtohet Gjykatës **vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj**, në praktikë aktet juridike që janë objekt kontrolli kushtetues janë zakonisht vendimet (aktgjykimet apo aktvendimet) e **Gjykatës Supreme të Kosovës**.

I rëndësisë së veçantë në këtë aspekt është koncepti **shkelje** e supozuar e lirive dhe të drejtave kushtetuese nga ana autoritetit publik ndaj një personi, si bazë mbi të cilën mund të iniciohet ushtrimi i këtij juridiksioni. Kjo do të thotë se shkelja i atribuohet veprimit të një organi publik që është materializuar në një akt juridik konkret të organit të tillë. Në parim, pra, në mënyrë që shkelja e një të drejte apo lirie kushtetuese të ndodhë, duhet që të ketë një **veprim** të një organi publik. Ka pasur raste, megjithatë, kur Gjykata ka vendosur në dobi të palës së viktimizuar pa pasur një veprim, përkatësisht akt konkret individual të organit publik kosovar. I tillë ka qenë rasti, ta zëmë, **Bislimi v. Ministria e Brendshme,**[242] kur Gjykata ka vendosur parimin që jo vetëm shkelja kushtetuese e bërë përmes një **veprimi** të një institucioni publik, por edhe **heqja dorë** apo **abstenimi** i një institucioni publik për të ndërmarrë një veprim, e cila, si pasojë, sjell një shkelje të të drejtave dhe lirive kushtetuese është bazë për përfitim nga ky juridiksion. Në kuptim të nenit 113.7, pra, **veprimi** dhe **mosveprimi** i një autoriteti publik mund të jenë shkaqe mbi të cilat kryhet **shkelja** kushtetuese, e cila është bazë për ushtrimin e autorizimit të palës për të ngritur çështjen para Gjykatës në kuptim të këtij neni.

---

240 Cf. më shumë për këtë në Enver Hasani, Fisnik Korencia & Dren Doli, "Individual Complaint Mechanism as a Means to Protecting Fundamental Human Rights and Freedoms: The Case of the Constitutional Court of Kosovo". *European Yearbook of Human Rights* (Intersentia: The Hagues, 2012).

241 *Rasti KI 63/09. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtruesi: Bajram Santuri. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren c. nr. 368/2000, të 8 majit 2003, Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. 46/2005 (C. nr. 99/07), të 28 dhjetorit 2006, si dhe të vendimeve të gjykatave në Suedi dhe aktgjykimeve Nr. 8329/06 dhe 9095/07 të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. N**r. ref.: RK132/11. Prishtinë, më 17 gusht 2011. Paragrafi 49:
"[…] 49. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, ngjarjet që kanë ndodhur në Suedi si dhe vendimet e GJEDNJ-së, për të cilat ankohet parashtruesi i kërkesës, nuk janë të ndërlidhura me autoritetet publike në Kosovë, siç kërkohet me nenin 113.7 te Kushtetutës dhe 47(1) te Ligjit, dhe rrjedhimisht bien jashtë juridiksionit të Gjykatës […]"; Në paragrafët 43-44, Gjykata kishte gjetur rastin si të papranueshëm sa i përket kërkesës së parë për shkak të **ratione temporis**.

242 Rasti **KI 06/10**, aktgjykim, paragrafi IV.

Në kuptim të efektit juridik të vendimeve të Gjykatës të lëshuara sipas këtij juridiksioni, duhet thënë që, në kundërshtim me kontrollin kushtetues abstrakt ku vendimet kanë karakter **erga omnes** të veprimit, në këtë juridiksion vendimet e Gjykatës kanë efekt **inter partes**, për aq kohë sa objekti i vendimit është restaurimi i një të drejte apo lirie kushtetuese të palës të shkelur në një rast individual/konkret. Gjykata, megjithatë, nuk është e kufizuar në lëshimin e vendimeve **inter partes** kur ushtron juridiksionin sipas këtij neni. Kështu, ta zëmë, në rastin **Tomë Krasniqi v. RTK et al.,** Gjykata ka vepruar brenda juridiksionit 113.7, mirëpo, për të sanuar shkeljen kushtetuese ndaj palës u detyrua që të pezullojë zbatimin e një akti juridik abstrakt. Për këtë arsye, pjesa e vendimit që e invalidon aktin abstrakt për shkak të kundërkushtetutshmërisë ka karakter **erga omnes**, pavarësisht që jepet në kuadër të juridiksionit nga neni 113.7, ndërsa, pjesa që i referohet shkeljes specifike dhe restaurimit të të drejtës së kërkuesit (parashtruesit), ka efekt juridik **inter partes.**

Kjo, megjithatë, nuk do të thotë se, në ushtrimin e këtij juridiksioni, Gjykata Kushtetuese shndërrohet në një **instancë të katërt gjyqësore**. Juridiksioni, sipas këtij neni, ka natyrë mjaft gjyqësore, mirëpo vendimet e Gjykatës janë thjeshtë vlerësuese të kushtetutshmërisë së vendimit individual të një autoriteti publik, zakonisht të vendimeve të **Gjykatës Supreme të Kosovës**, me të cilin zgjidhet një rast konkret apo mosmarrëveshje. Me një fjalë, Gjykata Kushtetuese gjen shkelje kushtetuese dhe nuk vendos vetë për rastin, duke ia lënë këtë gjyqësorit të rregullt, aty ku ka ndodhur shkelja kushtetuese, që vetë ta përmirësojë (korrigjojë) shkeljen e tillë kushtetuese. Vendimet sipas këtij juridiksioni bëhen të detyrueshme për gjyqësorin e rregullt ashtu që ky i fundit nuk e humb juridiksionin në rigjykimin e tyre: ky rigjykim më pastaj duhet të bëhet në linjë me rekomandimet (gjetjet) kushtetuese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Kjo bën që juridiksioni i gjyqësorit të rregullt realisht të mos huazohet apo uzurpohet në asnjë mënyrë nga Gjykata Kushtetuese.[243]

Është e rëndësishme të argumentohet që Kushtetuta nuk lejon hapësirë për një **actio popularis**. Ky juridiksion për dy arsye nuk përbën një **actio popularis**.

- një, sepse në fitimin e autorizimit për të ankimuar një **shkelje kushtetuese** në Gjykatën Kushtetuese, parashtruesi duhet që të ketë qenë **viktimë** e shkeljes së tillë, dhe të ketë interes direkt në rastin. Kjo përbën kusht procedural sipas nenit 113.7; dhe,
- dy, sepse në fitimin e autorizimit për të ankimuar një **shkelje kushtetuese**, parashtruesi duhet që parimisht të **faktojë** që një akt individual (qoftë në formë të veprimit apo mosveprimit) i institucionit publik ngërthen shkeljen e të drejtës apo lirisë së tij kushtetuese.

Me **Krasniqi v. RTK,** Gjykata ka vendosur një mekanizëm inovativ të konsiderimit të kësaj çështjeje: megjithëse e aktivizuar sipas juridiksionit të nenit 113.7, Gjykata pranoi të gjykonte çështjen me kërkesën e palës që pohonte **se ishte privuar nga një e drejtë kushtetuese në mënyrë të drejtpërdrejt nga një ligj.** Në këtë rast, prandaj, objekti i kontestit kushtetues mbi të cilin parashtruesi e argumentonte shkeljen e të drejtës së tij kushtetuese ishte një ligj i parlamentit (përkatësisht, një akt juridik abstrakt). Gjykata inovoi një lloj gjysmë **actio-popularis**, duke lejuar që, megjithatë, një parashtrues të mund të kontestojë kushtetutushmërinë e një ligji nëse **ligji në fjalë është burim i drejtpërdrejtë i shkeljes së të drejtës së tij/saj kushtetuese.** Nga kjo del se, në kuptim të **Krasniqi v. RTK**, shfrytëzimi i juridiksionit të nenit 113.7 nga ana e një parashtruesi individual, për të kontestuar kushtetutshmërinë e një ligji për shkak të shkeljes së një të drejte të tillë, është i lejueshëm për aq kohë sa parashtruesi është në gjendje të argumentojë që është **viktimë direkte** e një normë abstrakte që i shkel atij një të drejtë kushtetuese. Dhe, jo vetëm kaq. Në kuptim të **Krasniqi v. RTK**, një parashtrues individual (person fizik apo juridik), mund të kontestojë para Gjykatës kushtetutshmërinë e një akti abstrakt me kusht që:

- parashtruesi është viktimë e një akti të përgjithshëm, për shkak se i është shkelur një e drejtë kushtetuese;
- parashtruesi është në gjendje të argumentoj që akti i tillë i përgjithshëm përbën **veprim direkt** në

[243] Cf., ta zëmë, Lech Garlicki, "Constitutional Courts Versus Supreme Courts", fq..44-68.

shkeljen e të drejtës së tij kushtetuese;

- parashtruesi ka **interes direkt** në restaurimin e shkeljes së tillë, dhe që akti abstrakt që përbën shkelje të së drejtës së tij kushtetuese është efektiv, përkatësisht që nuk ka mjet tjetër efektiv për të kërkuar shfuqizimin e tij.

Në ushtrimin e këtij juridiksioni, siç është vendosur edhe në rastin **Tomë Krasniqi v. Radio Televizioni i Kosovës (RTK),** Gjykata është e lirë që **sua sponte**, përderisa është në zgjidhje të kërkesës së parashtruesit, **ultra petitum** të vlerësojë dhe të hapë rrethin e akteve juridike që mendon se janë duke shkaktuar shkeljen e paraqitur nga pala. Prandaj, në ushtrimin e këtij juridiksioni, Gjykata mund të veprojë **ultra petitum,** dhe të kontrolloj edhe kushtetutshmërinë e akteve tjera juridike, pavarësisht nëse janë objekt i kërkesës së palës, derisa **bindshëm** të jetë arsyetuar që shkelja e pretenduar nga ana e parashtruesit është sanuar.

Këto argumentime tona lidhur me precedentin e vënë nga Gjykata në rastin **Tomë Krasniqi v. RTK**, megjithatë, nuk përbëjnë një praktikë standarde të Gjykatës dhe, si të tilla, mund të ndryshojnë në një rast tjetër në të ardhmen. Për të ndryshuar kjo, sikundër dihet, kërkohet një arsyetim i Gjykatës. Deri atëherë, këto janë argumentet që duhen ndjekur me rastin e arsyetimit të shkeljeve kushtetuese nga neni 113.7. Kjo nga shkaku se, sikundër u tha me herët, juridiksioni kosovar në lëmin e ankesës kushtetuese modelohet sipas sistemit gjerman të **ankesës së plotë**, ku me rëndësi është që të sanohet shkelja e të drejtave dhe lirive kushtetuese nga ana e autoriteteve publike dhe që kjo të bëhet në një mënyrë efektive. Akti individual mund të jetë jokushtetues si pasojë e veprimeve të nxjerrësit të tij, por mund të derivojë edhe si rezultat i zbatimit në një rast individual /konkret të normave që prodhojnë efekte jo kushtetuese. Në rastin e fundit, vendimi konkret individual i autoritetit publik mund të mungoj, siç ka qenë situata te **Tomë Krasniqi v. RTK**, e megjithatë ekziston pasoja antikushtetuese të cilën e bartë në kurriz individi të cilit nuk i ofrohen mjete tjera të rregullta dhe efektive. Në jurisprudencën e **Strasburgut**, mjeti juridik i ankesës kushtetuese konsiderohet si efektiv nëse sipas të drejtës nacionale ushtrimi i saj mund të korrigjojë në mënyre efektive shkeljet e lirive dhe të drejtave njerëzore të kryera nga autoritetet vendore. Në Kosovë, ankesa kushtetuese ka statusin e një mjeti efektiv juridik sepse i mundëson palës sanimin e cenimit të lirive dhe të drejtave kushtetuese të kryer nga ana e autoriteteve publike gjatë ushtrimit të autorizimeve të tyre të mandatuara me kushtetutë. Nëse nuk ka mjet dhe rrugë tjetër për sanimin e një cenimi kushtetues të lirive dhe të drejtave njerëzore, i cili bazohet në zbatimin në praktikë të një norme të përgjithshme kushtetuese, atëherë **veprimi i tillë individual në një rast konkret i autoritetit publik** duhet të cilësohet si **vendim** në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës, Siç ka qenë situata në **Tomë Krasniqi v. RTK.** Mbetet të shihet si do të veprohet në të ardhmen në jurisprudencën kosovare.

11.3.8. Juridiksioni nga neni 113.8 i Kushtetutës si juridiksion konkret derivativ në lëmin e kontrollit incidental të kushtetutshmërisë

Neni 113.8 përcakton juridiksionin **incidental** të Gjykatës Kushtetuese. Ndryshe, në literaturën komparative, ky juridiksion njihet edhe si **qasja e tërthortë në gjykatë**, çështja paraprake e kushtetutshmërisë etj. Kjo dispozitë thotë se gjykatat e rregullta kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë. Kjo nënkupton se nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese lidhur me kushtetutshmërinë e ligjit apo të dispozitës së tij varet rezultati përfundimtar i rastit që është duke u zgjidhur prej gjykatës referuese: spekulimi hipotetik se jo kushtetutshmëria e një ligji apo dispozite ligjore mund të shkaktojë rezultate jokushtetuese në rastet konkrete gjithandej nëpër gjyqësorin e rregullt, nuk përbën një argument të vlefshëm.[244] Juridik-

[244] *Rasti KO 04/11. Aktgjykim. Parashtrues: Gjykata Supreme e Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë se neneve 35, 36, 37 dhe 38 te Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme, Nr. 03/L-139***. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.: AGJ203/12. Prishtinë, më 1 mars 2012. Paragrafi 31; *Rasti KO 126/16. Aktvendim për Papranueshmëri. Gjykata Referuese: Kolegji i Specializuar i Dhomës se Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare te Privatizimit. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. OS/L-120 për Trepçën*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës** Nr. ref.: RK 1086/17. Prishtinë, më 30 maj 2017. Paragrafët: 62, 64 & 68.

sioni **incidental,** thënë ndryshe, është një hapësirë ku gjykatat e rregullta, gjatë vendosjes së një rasti apo mosmarrëveshje individuale dhe krejt konkrete, ndjejnë nevojën e qartësimit të kushtetutshmërisë së një ligji, të cilin ato duhet ta zbatojnë me rastin e vendosjes së atij rasti apo zgjidhjes së asaj mosmarrëveshje individuale dhe konkrete, por që nuk janë të sigurta nëse ligji apo ndonjë dispozitë e tij janë kushtetuese.[245] Lidhja në mes të kushtetutshmërisë së ligjit apo dispozitës së tij me çështjen konkrete që pret për t'u zgjidhur/vendosur në gjykatën referuese **duhet të jetë i natyrës së drejtpërdrejtë, jo një lidhje hipotetike dhe e tërthortë: gjykimi në gjykatën referuese nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga verdikti i Gjykatës Kushtetuese, e cila e zgjidh çështjen e antikushtetutshmërisë së ligjit të referuar, përkatësisht dispozitave të tij.**[246] Për të larguar këtë pasiguri nga vetja, gjykatat e rregullta iniciojnë çështjen e kushtetutshmërisë së ligjit në fjalë para Gjykatës Kushtetuese. Juridiksioni incidental përbën mekanizmin që mundëson ndarjen e funksioneve të gjykatave të rregullta dhe Gjykatës Kushtetuese.[247] Në këtë procedurë, gjykatat e rregullta nuk vazhdojnë me zbatimin e një ligji para se ta kenë kërkuar qartësimin e kushtetutshmërisë së tij nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Sistemet e gjyqësisë kushtetuese me **model të decentralizuar** janë ato që kanë një ndarje në mes të gjyqësisë së rregullt dhe gjykatës kushtetuese. Në këtë kuptim ky juridiksion ka natyrë derivative. Ky lloj i juridiksionit nuk gjendet në **modelin e decentralizuar** të gjyqësisë kushtetuese sepse bie ndesh me natyrën e sistemit të tillë.[248] Në modelin e decentralizuar, vendosja për kushtetutshmërinë e normës është pjesë përbërëse e rastit dhe mosmarrëveshjes (case and controversy) dhe zgjidhte së bashku me te me efekt inter partes. Edhe kur një rast individual dhe konkret certifikohet për t'u vendosur si një çështje kushtetuese në instancën më të lartë, siç është **Gjykata Supreme e SHBA**-ve, nuk ka një procedurë gjyqësore më e ulët që pret verdikitin përfundimtar kushtetues sepse ai verdikt në të njëjtën kohë e zgjidh rastin dhe mosmarrëveshjen dhe i shërben qëllimit unifikues të sistemit ligjore dhe kushtetues (**funksioni nomofilatik**), jo si një ndihmesë për një instancë tjetër më të ultë gjyqësore për ta zgjedhur një rast dhe mosmarrëveshje konkrete që ndodhet pranë saj.[249]

Juridiksioni **incidental** i Gjykatës mund të aktivizohet nga cilado gjykatë e rregullt e Republikës së Kosovës, me kusht që ligji kontrolli i kushtetutshmërisë së të cilit kërkohet është burim i së drejtës për çështjen individuale konkrete që është duke u zgjidhur nga ana e gjykatës së rregullt. Me inicimin e kërkesës për kontroll të kushtetutshmërisë së një ligji, gjykata e rregullt obligohet që të mos nxjerrë vendimin përkitazi me rastin në fjalë përpara se ligji të ketë kaluar filtrin e Gjykatës Kushtetuese. Duhet thënë që, në kuptim të këtij paragrafi, vetëm gjykatat e rregullta, përkatësisht gjyqtarët/kolegjet e gjyqtarëve që janë duke gjykuar një çështje, kanë të drejtë të ushtrojnë iniciativën e kontrollit kushtetues të ligjeve

---

245 Ky standard i pasigurisë së gjykatës referuese, megjithatë, ka përjashtime: në jurisprudencën gjermane nuk mjafton vetëm dyshimi i zakonshëm për jokushtetutshëmrinë, por duhet të ekzistojnë një shkallë me fortë e bindjes së gjyqësori të rregullt, përkatësisht duhet të jenë të bindur që një ligj apo dispozitën ligjore është antikushtetuese. Kjo shpjegon arsyen pse në **Gjermani** gjykatat janë të detyruara të referojnë çdo ligj apo dispozitë ligjore për të cilën ata janë të bindur se është jokushtetuese, u mor vesh gjithnjë me supozimin se fjala është për ligjin apo dispozitën me relevancë të drejtpërdrejtë dhe aplikim të drejtpërdrejtë në një çështje që pret vendosje/zgjidhje nga gjykata referuese. Cf. Wilhelm Karl Geck, "Judicial Review of Statutes. A Comparative Survey of Present Institutions and Practices" *Cornell Law Review* Vol. 51 Issue 2 (Winter, 1966) fq. 250-304 në fq. 279-280; Hans G. Rupp, "Federal Constitutional Court in Germany: Scope of Its Jurisdiction and Procedure". *Notre Dame Law Review* Vol. 44 Isue 4 (1969) fq. 557-558; Wolfgang Zeidler, "Federal Constitutional Court of the Federal Republic of Germany: Decisions on the Constitutionality of Legal Norms". *Notre Dame Law Review* Vol. 62 Issue 4 (1987) fq. 504-525 në fq. 505-506; European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Study on Individual Access to Constitutional Justice,* paragrafi 62.

246 *Rasti KO 142/16. Aktgjykim. Parashtrues: Kolegji i Apelit i Dhomes se Posacme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Vlerësim i kushtetutshmërise së neneve 10 dhe 40.1.5 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtine, mc 18 korrik 2017. Paragrafët: 59-61, 63-64, 73.

247 Rasti **KO 04/11**, aktgjykim, paragrafi 34.

248 European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Study on Individual Access to Constitutional Justice*, parag. 56

249 Wilhelm Karl Geck, " Judicial Review of Statutes. A Comparative Survey of Present Institutions and Practices", fq. 273-276; 285-287 (ku autori flet për dallimin substancial në mes të sistemit të decentralizuar dhe atij të centralizuar të kontrollit kushtetues, duke përjashtuar mundësinë që **kontrolli incidental** të ketë kuptim në modelin e decentralizuar të gjyqësisë kushtetuese, model në të cilin, në fakt, çdo kontroll i kushtetutshmërisë së një norme të përgjithshme juridike kryhet së bashkë dhe përgjatë procesit të zgjidhjes/vendosjes lidhur me një rast apo mosmarrëveshje konkrete dhe indvividuale).

sipas këtij juridiksioni. Kjo e drejtë nuk u takon palëve në rastin që është duke u zgjidhur nga gjykata e rregullt.[250] Gjykatat e rregullta, për më tepër, kanë të drejtë që **ex officio** të ngritin çështjen e kontrollit incidental me kusht që kushtetutshmëria e ligjit apo e dispozitës konkrete ligjore ka relevancë të drejtpërdrejtë në rezultatin e përfundimtar të rastit që pret të vendoset/zgjidhet pranë gjykatës së rregullt referuese.[251] Kjo relevancë e drejtpërdrejtë nënkupton që ai ligj apo dispozitat e tij duhet jenë pikërisht ato që duhet të zbatohen drejtpërdrejtë në rastin apo mosmarrëveshjen konkrete që pret të vendoset/zgjidhjet pranë gjykatës së rregullt: gjykata e rregullt nuk mund të referojë një ligj apo dispozitë ligjore që nuk ka relevancë të drejtpërdrejtë, përkatësisht që nuk duhet të zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në zgjidhjen/vendosjen e rastit konkret pranë gjykatës referuese, ani se ai ligj apo ato dispozita mund të jenë anti-kushtetuese.[252] Kjo është kështu sepse gjykatat e rregullta në Kosovë dhe në vendet tjera që kanë model **evropian/kelsenian** të gjyqësisë kushtetuese nuk kanë të drejtë dhe autorizim për të ngritur rastet e kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë.[253] Me gjykatë refereuese nënkuptohet gjyqtari apo trupi gjykues që është kompetent për të zgjidhur /vendosur rastin apo mosmarrëveshjen konkrete individuale, i cili gjatë këtij procesi ka hasur në një ligj apo dispozitë ligjore që duhet ta zbatojë drejtpërdrejtë sepse kanë relevancë të drejtpërdrejtë për rastin apo mosmarrëveshjen e tillë. Me gjykatë referuese nuk nënkuptohet secili gjyqtar apo eprori i ndonjë departamenti në një gjykatë të rregullt brenda së cilës një gjyqtar i vetëm apo një kolegj gjyqësor kanë në shqyrtim dhe vendosje/zgjidhje një rast apo mosmarrëveshje ndaj së cilës duhet të zbatohet një ligj apo dispozitë ligjore në kushtetutshmërinë e të cilave ka dyshime nga ai trup gjykues apo gjyqtar individual kompetent.[254]

Në disa sisteme kushtetuese, kërkesa e palëve e detyron gjykatën që menjëherë t'i ndalë procedurat që janë në vijim para saj dhe ta referojë çështjen në gjykatën kushtetuese. Ky nuk është rasti në **Kosovë** sepse gjykata e rregullt e çështjes ka diskrecion të plotë për të vendosur mbi referimin apo jo të çështjes në gjykatën kushtetuese. Nëse gjykata e rregullt refuzon kërkesën, atëherë ajo duhet ta arsyetojë mirë refuzimin e tillë dhe ta konstatojë përmes procesverbalit. Kjo sepse, në të kundërtën, vendimi për refuzim mund të shpallet më vonë si vendim që ka cenuar të drejtat dhe liritë kushtetuese të palës që ka kërkuar kontrollin **incidental.**[255] Në disa shtete, jo të gjitha gjykatat e rregullta kanë autorizim për të referuar çështje të kontrollit incidental: në **Austri**, **Bullgari**, **Itali** dhe në disa vende tjera kjo e drejt u takon vetëm instancave më të larta të gjyqësori të rregullt në nivel nacional.[256]

Në vijim për sa më sipër, në ushtrimin e këtij juridiksioni në disa vende, gjykata kushtetuese detyrohet të shqyrtojë edhe çështjet e **faktit,** jo thjeshtë vetëm çështjet juridike-kushtetuese.

---

[250] Në gjyqësinë kushtetuese komparative ka përjashtim nga kjo rregull: në **Rumani** dhe **Sllloveni**, gjykatat duhet të referojnë çështjen e **kontrollit incidental** në gjykatë kushteteuse në rastet kur një gjë e tillë ngritët nga njëra prej palëve në në një procedurë të rregullt gjyqësore. Ibid. Parag. 59.

[251] Rasti **K0 126/16**, aktvendim, paragrafi 52 (duke iu referuar rregullit 75 të **RP** të Gjykatës Kushtetuese).

[252] Ibid. Paragrafët. 62-66 & 77 të aktvendimit.

[253] Ibid. Paragrafi 75 i aktvendimit.

[254] Në një rast në **Gjykatën Kushtetuese**, një shef i departamentit të krimeve të rënda kishte referuar një rast, pa qenë i autorizuar për një gjë të tillë meqë rasti nuk ishte në duart e tij për t'u vendosur por në duart e një kolegji gjyqtarësh të krimeve të rënda. Për pasoj, rasti u shpall i papranueshëm. Cf. *Rasti KO 59/14/ Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Hilmi Hoxha. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 29.2 dhe 38.2 të Kodit të Procedurës Penale dhe të neneve 11.1dhe 39.2 të Ligjit për gjykatat*. Nr. ref.: RK 672/14. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 14 korrik 2014. Paragrafet. 54-57; Si dhe paragrafi 56 në AKTVENDIM PËR PAPRANEUSHMËRI në rastin nr. **K0 126/16**.

[255] Cf. më shumë për aspekte komparative të **incidental** dhe rolin e palëve në procedurë pranë gjykatave të rregullta në inicimin e kontrollit incidental, në: European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission). *Study on Individual Access to Constitutional Justice*, pargrafet 56-62.

[256] Kjo përvojë bazohet në synimin për të ngritur cilësinë e referimeve në gjykatën kushtetuese nga ana e gjyqësorit të rregullt. Cf. Ibid., paragrafi 61.

Në këto raste kërkesa e parashtruesit e paraqitur me ankesën kushtetuese mund që t'i referohet fakteve që kanë sjellë tek shkelja e së drejtës kushtetuese të parashtruesit.[257] Ky nuk është rasti në **Kosovë**, ku Gjykata duhet të kufizohet vetëm në çështjet juridike duke i lënë çështjet faktike për zgjedhje gjykatave të rregullta.[258]

Juridiksioni incidental i Gjykatës Kushtetuese, prandaj, përbën një procedurë ku gjyqësori i rregullt komunikon me Gjykatën Kushtetuese në mënyrë që gjyqësori të luajë rolin e një iniciuesi të kontrollit të kushtetutshmërisë dhe të kontribuojë në uniformitetin juridiko-kushtetues të rendit kushtetues kosovar. Shikuar në këtë kuptim, gjykatat e rregullta nuk kanë autoritet për të vendosur në lidhje me kushtetutshmërinë e çështjeve. Ky funksion i takon vetëm Gjykatës Kushtetuese.[259] Dispozita e nenit 102.3 ["Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor"] i Kushtetutës që thotë se gjykatat e rregullta gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit, asnjëherë nuk kupton mandatimin e gjyqësorit të rregullt për të bërë interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.[260] Më këtë frazë asnjëherë nuk duhet të kuptohet se gjyqësorit të rregullt i takon intepretimi autoritativ i Kushtetutës. Kjo frazë nuk ka asnjë kuptim tjetër pos që tregon hierarkinë e burimeve të së drejtës në Kosovës, së cilës duhet çdokush t'i nënshtrohet, gjyqësori në veçanti për arsye në punën e përditshme merret me interpretimin e akteve juridike që quhen ligje dhe që në hierarkinë e burimeve vijnë menjëherë pas Kushtetutës.

Shikuar edhe në aspektin historik, kësisoj ka lindë ideja e **kontrollit incidental**: në luftën për themelimin e gjyqësisë kushtetuese në mes të dy luftërave është dashur që të ruhet dinjiteti i gjyqësorit të rregullt, i cili çdoherë gjatë historisë pas **Revolucionit Francez** e tutje është asocuar me të qenit vegël e pushtetit shtetëror. Ruajtja e dinjitetit është synuar të bëhet duke ia lënë gjyqësorit të rregullt një derë ndikimi në procedurat e sigurimit të supremacisë (epërsisë) së kushtetutës, si akti i parë në hierarkinë e burimeve të së drejtës në nivel nacional. Kjo nuk ka ndryshuar që nga koha në mes të dy luftërave botërore kur është bërë përplasja e ideve për dhe kundër themelimit të gjyqësisë së ndarë kushtetuese në sistemet kushtetuese të vendeve në dy anët e **Atlantikut**.[261] Thënë ndryshe, mekanizmi i **kontrollit incidental**, dje dhe sot, në këtë kontekst ndihmon shumë që gjykatat e rregullta të kenë parasysh kushtetutën kur gjykojnë, jo vetëm ligjin, dhe çdoherë kur kanë dilema për kuptimin e dispozitave të kushtetutës t'i drejtohen gjykatës kushtetuese nacionale për të marrë verdiktin e formës së prerë, përfundimtar dhe të ekzekutueshëm lidhur me atë cili është kuptimi kushtetues i ligjit që që ato duhet ta zbatojnë në një rast apo mosmarrëveshje konkrete dhe individuale. Kjo është kështu sepse vetëm gjykatat kushtetuese kanë mandat të monopolizuar kushtetues dhe ekspertizë të duhur për të për të treguar nëse një një ligj apo normë tjetër e përgjithshme që duhet të

---

257 Cf., ta zëmë, Eivind Smith, "Courts of people, not of norms? Law and fact in constitutional Review as performed by courts of general or administrative jurisdiction". European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *International Conference. Law and Fact in Constitutional Jurisprudence*, 30 June - 1 July 2005, Vilnius, Lithuania. *CDL-JU(2005)022* (fq.4).

258 Si shembull krahasues nga jurisdiksioni i **Gjykatës Kushtetuese të Çekisë**, në përputhje me jurisprudencën e saj konsistente, ku kjo gjykatë ka vendosur që nuk i rishqyrton provat e shqyrtuara nga gjykatat e rregullta. Megjithatë, në rrethanat kur një aktgjykim dënues bazohet vetëm në një dëshmi të tërthortë (rrethanore), veç kësaj, të karakterit thjeshtë mbështetës apo subsidiar, dhe kur gjykata ka refuzuar t'i shqyrtojë provat tjera të ofruara nga i padituri, gjykata e rregullt i ka shkelur të drejtat dhe liritë fundamentale të të padituri, të garantuara me Kushtetutë. (Vendim i **Gjykatës Kushtetuese të Republikës Çeke** I. US 394/97 i datës 04.03.1998);

259 Rasti **KO 04/11**, aktgjykim, paragrafi 35.

260 Për logjikën e njëjtë të argumentimit të themeluesit të gjyqësisë së ndarë kushtetuese ashti siç e njohim sot, cf. më shumë në Hans Kelsen, "Judicial Review of Legislation: A Comparative Study of the Austrian and the American Constitution". *Journal of Politics* Vol. 4 No.2 (May, 1942) fq. 185–186.

261 Fjalën e kemi për debatin aq aktual sot në mes të Karl Shmit e Hans Kelsen, i cili konsiston në përplitjet për të vendosur se ku duhet të kërkohet gardiani i kushtetutës, në institucionin e Shefit të Shtetit apo në një organ të ndarë gjyqësor me juridiksion të qartë kushtetues për të siguruar supremacinë (epërsinë) e kushtetutës kundrejt ligjvënësit, ekzekutivit dhe gjqyësorit të rregullt dhe formave tjera të dhënies së drejtësisë. Cf. Karl Smit, "Cuvar ustava". Në Slobodan Samardzic (ed.), *Norma i Odluka. Karl Smit i njegovi kriticari* ("Filip Visnjic": Beograd, 2001) fq. 211-253 në veçanti në fq. 215-216 dhe 218-219 (Titulli i origjinalit: Carl Schmitt, "Der huter der verfasung". A*rchiv des offentlichen rechts*. Neue Folge 16 Band J.C.B. Mohr (Paul Siebeck), Tubingen 1929); Hans Kelsen, "Ko treba da bude cuvar ustava" Në Slobodan Samardzic (ed.), *Norma i Odluka,* fq. 257-297(Titulli në original: Hans Kelsen, *Wer soll der huter der verfassung sein?* (Dr. Walther Rothschild, Berlin-GruNewald, 1931).

zbatohet në një gjykim konkret dhe individual është në pajtim me kushtetutën.[262] Kjo qasje, në të njëjtën kohë nënkupton që kur gjyqësori i rregullt me rastin e vendosjes në një rast apo mosmarrëveshje bën gabime në interpretim të dispozitave kushtetuese, ato gabime sanohen përmes procedurave të ankesës individuale që kanë për objekt kontrollin kushtetues të vendimeve të çdo autoriteti publik. Aty ku nuk ka ankesë efektive kushtetuese, ankesë të plotë kushtetuese, siç është rasti me **Italinë**, kontrolli incidental ka një rol shumë aktiv dhe të rëndësishëm. Përmes kontrollit incidental, italianët kanë arritur ta pastrojnë rendin e tyre kushtetues nga ligjet dhe dispozitat tjera të përgjithshme të kohës fashiste.[263]

Qasja sipas së cilës **gjykatat gjykojnë në bazë të kushtetutës dhe ligjit** ka lindur vetëm pas **Luftës së Dytë Botërore** kur në vendet e demokracive tradicionale perëndimore u kristalizua pikëpamja se kushtetutat, në veçanti karta e tyre mbi liritë dhe të drejtat njerëzore, janë dokumente ligjore Si çdo ligj tjetër që mund dhe duhet të zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, e jo më të shërbejnë si tekste programatike dhe propagandistike të përbëra nga deklarata abstrakte mbi synimet lidhur me mënyrën e organizimit të pushtetit shtetëror. Në ndërkohë që këtë detyrë gjykatat e rregullta nuk do të mund ta luanin si duhet, atëherë u ruajt versioni i gjyqësisë kushtetuese që vihet në lëvizje sipas kërkesës për kontroll incidental: ky mekanizëm nuk ishte veçse një paaftësi e demokracive të reja për t'u shkëputur në tërësi nga e kaluara e tyre e mbështetjes në gjyqësorin e rregullt, duke lënë të paprekur mundësinë që gjyqësia e re kushtetuese të kishte një lidhje me të kaluarën. Në këtë mënyrë u krijua mekanizimi i **kontrollit incidental**, si një procedurë me mjaft ndikim në realizimin e drejtpërdrejtë të dispozitave të kushtetutës nga ana e gjyqësorit të rregullt përmes ndihmës së gardianit të kushtetutës – gjykatës kushtetuese të ndarë dhe të veçantë nga ky gjyqësor i rregullt. Në fakt, pas mekanizimit të ankesës kushtetuese, ky mekanizëm përbën të dytin me radhë për nga rëndësia e vënies në jetë të dispozitave kushtetuese lidhur me liritë dhe të drejtat njerëzore. Në disa vende, siç është rasti me **Italinë**, mekanizmi i kontrollit incidental ka shërbyer si zëvendësim dhe kompensim për mosfutjen e ankesës kushtetuese: gjyqtarët e gjyqësorit të rregullt dhe instancat tjera kuazi-gjyqësore kanë shërbyer si urë lidhëse e një bashkëpunimi mjaft të frytshëm të gjyqësisë së rregullt me gjyqësinë kushtetuese italiane në vijim të mbrojtjes së rendit të ri kushtetutës në këtë vend, i krijuar me shumë mund pas **Luftës së Dytë Botërore.**[264] Në këtë kontekst, **Gjykata Kushtetuese e Italisë** ka luajtur funksionin kryesor të modernizimit dhe pastrimit të sistemit legal italian nga ligjet dhe kodet antikushtetuese të kohës fashiste por edhe të shekullit XIX.[265]

Një çështje për t'u veçuar është ajo që ka të bëjë me atë se sa shfrytëzohet ky mekanizëm në praktikë, shqetësim që **Gjykata Kushtetuese** e ka shprehur në njërin nga vendimet e saj.[266] Shumë rrallë, në fakt. Pse? Ka dy arsye pse kjo është kështu. e para, sepse gjyqësori i rregullt nuk ka ekspertizë në çështjet e implementimit të kushtetutës por vetëm të ligjeve, një fushë shumë më e ndryshme në veçanti kur flitet për vënien në jetë të dispozitave kushtetuese mbi të drejtat dhe liritë kushtetuese; dhe, e dyta, sepse gjyqësori i rregullt edhe ashtu ka shumë punë për të bërë dhe ngarkesë të madhe me lëndë të përditshme, aq shumë sa

---

[262] Helmut Steinberger, "Models of Constitutional Jurisdiction", fq. 14.

[263] Për një shtjellim të shkëlqyer të këtij problemi në vitet e para të themelimit të Republikës Italiane dhe të gjyqësisë kushtetuese italiane, cf. shtjellimet e njerëit prej konstitutcionalistëve më te njohur italian të të gjitha kohërave, Franco Pierandrei, *Scritti di diritto costituzionale. Volume secondo* (G. Giappichielli Editore: Torino, 1964) fq. 29-38.

[264] Cf. Guido Neppi Modona, "Enhancing the Cooperation Bteëeen the Constitutional Court and the Judiciary: The Italian Experience". Në European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission). Report. CDL–JU(2014) 007. English only. Strasbourg, 12 May 2014. fq. 3-4. Në internet: http://www. venice. coe. int/ webforms /documents/ default.aspx?pdffile=CDL-JU(2014)007-e (shikuar në janar 2018);

[265] Tania Groppi, "The Italian Constitutional Court: Towards a 'Multilevel System' of Constitutional Review?" *Journal of Comparative Law* Vol. III Issue 2 (2008) fq. 100-117, në veçanti fq. 110-111.

[266] Cf. edhe paragrafin 34 të aktgjykimit në rastin **KO 04/11**, i cili paraqet rastin e parë në jurisprudencën e **Gjykatës Kushtetutese**, dy vjet pas fillimit të punës së saj. Në dy vitet e para të punës, vetë Gjykata ka zhvilluar disa seminare dhe konferenca për ngritjen e vetëdijes së gjyqësorit të rregullt dhe artereve tjerë, potencialisht palë të autorizuara sipas nenit 113 të Kushtetutës, për mundësitë që ofron Kushtetuta për mbrojtjen e të drejtave dhe autorizimeve të tyre përmes Gjykatës Kushtetuese. Këto trajnime dhe seminare të përbashkëta nuk duket se kanë dhënë ndonjë rezultat të madh, marrë parasysh numërin prej katër rasteve gjithsej të parashtruara deri më sot. Krahas rastit të parë si më sipër që është vendim meritor, vetëm edhe një prej katër rasteve tjera të vendosura është vendim meritor. Fjalën e kemi për aktgjykimi në rastin **K0 142/16.**

marrja me implementim të kushtetutës para ligjit do të përbënte një punë shtesë, pse jo edhe luks të llojit te vet.[267] Kjo vërtetohet edhe në rastin e **Kosovës:** nga hulumtimi që kanë bërë autorët e këtij libri ka dalë se shumë të rralla janë rastet kur gjykatat e rregullta thirren në Kushtetutë apo në praktikën e **Strasburgut** (që është e njëjta gjë meqenëse në **Kosovë** jurisprudenca e **Strasburgut** ka statusin e normës kushtetuese dhe përbën një detyrim të rreptë kushtetues për të gjitha autoritetet publike).[268] Ne disa prej gjykatave kushtetuese të Evropës ish-komuniste, që modelohen sipas sistemit gjerman, flitet për përpjekjet e gjykatës kushtetuese nacionale për të arritur efektin radius në raport me gjyqësorin e rregullt. Ky efekt radiues nënkupton se gjyqësori i rregullt me rastin e zbatimit të ligjit duhet të ketë çdoherë parasysh dimensionet kushtetuese të secilit ligj, bazuar në doktrinën e prezumimit kushtetues, ashtu që interpretimi i tyre të bëhet duke pasur parasysh balancimin e të drejtave e lirive kushtetuese që bien ndesh njëra me tjetrën. Në këtë kuptim, ta zëmë, gjykatat e rregullta janë të detyruara që t'i japin përparësi lirisë së shprehjes në krahasim me shpifjen kur të gjykojnë rastet civile. Kjo është esenca e efektit radiues të normës kushtetuese, ndaj tërë sistemit legal, duke i dhënë shije kushtetuese secilit ligj që duhet të zbatohet në një rast apo mosmarrëveshje konkrete.[269]

11.3.9. Juridiksioni nga neni 113.9 i Kushtetutës si realizim i doktrinës kosovare mbi amendamentet kushtetuese antikushtetuese

Ky nen përcakton që kryetari i Kuvendit **duhet** të referojë amendamentet e propozuara kushtetuese, para miratimit të tyre në Kuvend, në Gjykatën Kushtetuese për t'i kontrolluar nëse ato zvogëlojnë të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Ky paragraf, prandaj, përbën juridiksionin e kontrollit të amendamenteve kushtetuese, i cili vihet në veprim **në mënyrë të detyrueshme** sa herë që propozohen amendamente kushtetuese sipas procedurës së amendamentimit të Kushtetutës. Ky quhet kontroll paraprak i kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese dhe, siç do të shihet në vijim, është mjaft i rrallë në gjyqësinë kushtetuese komparative: **Afrika e Jugut**, rasti gjithsesi më interesant dhe më ekzemplar i këtij juridiksioni,[270] është vetëm njëri ndër të rrallët. Pse **Afrika e Jugut**? Pikërisht për arsye se ka pasur një sistem politik dhe kushtetues të bazuar në diskriminim të popullsisë shumicë me ngjyrë, i njohur si **apartheid**, ashtu që kontrolli kushtetues i amendamenteve i parashikuar në vitit 1996, ka shërbyer si pengesë

---

267 Louis Favoreu, Wanda Mastor, *Les cours constitutionnelles*, fq. 10-11; Për rastin polak, njërit ndër vendeve ish-komuniste me traditë të pasur në gjyqësinë kushtetuese, cf. Ryszard Cholewinski, "The Protection of Human Rights in the New Polish Constitution". *Fordham International Law Journal*. Vol. 22 Issue 2 (1998) fq. 236-291 (ku autori përshkruan vështirësitë e gjeneratës së parë pas rënies së komunizmit për të implementuar standardet e reja për të drejtat e njeriut dhe orientimin polak kah akademia e pakomprometuar, jo kah gjyqësori i rregullt, për të rekrutuar gjyqtarët e rinj kushteues në këtë vend)

268 Ky konstatim bazohet në hulumtimin që autorët e këtij libri e kanë bërë intensivisht në terren në atë pjesë të gjyqësorit të **Kosovës** që ka selinë në **Prishtinë**. E kemi fjalën për **Gjykatën Themelore** dhe **Gjykatën e Apelit**. Hulumtimi është kryer kryesish nga autori i dytë i libirt. Më 1 Qershor 2018 është mbajtur një Tryezë e Rrumbullakët me gjyqtarë nga Gjykata Themelore dhe nga Gjykata e Apelit. Temë e tryezës së rrumbullakët ka qenë identifikimi i nevojave në lidhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ dhe si ta zbatojnë atë në punën e përditshme të gjyqtarëve. Kjo tryezë e rrumbullaket është organizuar nga Akademia e Drejtësisë së Kosovës (ADK) dhe Projekti GIZ për reforme juridike dhe administrative. Gjyqtarët theksuan vështirësitë që hasin në shpërndarjen e përditshme të detyrave të tyre, për shkak të pamundësisë së qasjes së tyre në rastet e GJEDNJ. Një prej rekomandimeve të dala nga kjo tryezë ishte që është e domosdoshme që të ndodhë mbulimi i të gjitha neneve të KEDNJ-pasi që në Kosovë nuk ka burime në dispozicion për momentin. Aty u tha se ekzistojnë disa fusha ku ka më shumë vështirësi, siç janë. të drejtat e pronësisë, çështjet e kompensimit, ndalimi i paligjshëm, ngritja e aktakuzave pas kalimit të kohës, praktika e pa unifikuar, dëmtime materiale nga vendimet e institucioneve, rastet e vjetra që kanë të bëjnë me pronën shoqërore etj. etj. Po ashtu, nevoja për trajnim mbi mënyrën e përdorimit të jurisprudencës së GJEDNJ-së u theksua nga gjyqtarët, nisur nga fakti se mjaft shpesh ekziston një rezistencë ndaj zbatimit të rasteve të Strasburgut për shkak të pasigurive të zbatimit të standardeve në mënyrë korrekte. Në këtë kontekst, u vu në spikamë se ka nevojë për njohje më të thellë të standardeve të vendosura nga Gjykata Kushtetuese dhe devijimet nga këto standarde. Gjatë këtij takimi, gjyqtarët e Gjykatës Apelit përmenden vetëm një rast kur është referuar KEDNJ në një vendim të tyre (rasti Ac.nr.2577/15 i datës 21 tetor 2015, Gjykata e Apelit në Prishtinë).

269 *Zdeněk Kühn, " The Constitutional Court of the Czech Repoublic". Në* András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, *fq. 199-236 në fq. 200-203.*

270 Si një shembull krahasues mbi rëndësinë e regjimit parprak kushtetues, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Afrikës së Jugut refuzoi ta certifikojë **Kushtetutën e Republikës të Afrikës së Jugut** të vitit 1996, pasi që një numër dispozitave nuk ishin në përputhje me parimet kushtetuese të Kushtetutës së përkohshme të Republikës të Afrikës së Jugut të vitit 1993. (Vendim i **Gjykatës Kushtetuese të Republikës të Afrikës së Jugut** CCT 23/96 i datës 06.09.1996).

për rikthim të atavizmave nga e kaluara e hidhur e këtij vendi.[271] Kosova nuk është larg këtij botëkuptimi lidhur me teorinë dhe praktikën e amendamenteve jo kushtetuese dhe rolit të gardianit të kushtetutës në procesin e kontrollit të tyre kushtetues me qëllim të pengimit që të njëjtat të bëhen pjesë e tekstit aktual kushtetues. E tillë është natyra e dispozitave të neneve 113.9 dhe 144.3 të Kushtetutës. Sërish i kthehemi këtij segmenti në vijim.

Në kuptim të paragrafit 9-të të nenin 113 të Kushtetutës, dy janë çështjet që duhet diskutuar:

- *një*, hapësira e veprimit të Gjykatës në kuptim të kontrollit nëse amendamentet e propozuara kushtetuese zvogëlojnë të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës; dhe,
- *dy*, nëse vendimi i Gjykatës për mospërputhshmëri në rastin konkret prodhon efekt juridik të detyrueshëm për Kuvendin.

Sa i përket çështjes së parë, Gjykata në parim është e autorizuar që të kontrollojë thjeshtë dhe vetëm përputhshmërinë e amendamenteve të propozuara kushtetuese dhe kapitullit II të kushtetutës. Kështu thotë neni 113.9 lidhur me nenin 144. 3 të Kushtetutës. U mor vesh, vetëm nëse lexohet kuptimi **tekstual**, i pari kuptim që e jep secili tekst në lexim të parë. Në kuptimin **substancial dhe thellësisht teleologjik**, megjithatë, dispozitat kushtetuese si më sipër që normojnë anën procedurale dhe materiale të kontrollit kushtetues të amendamenteve kushtetuese duhet të interpretohen në dritën e detyrimit kushtetues nga neni 53 i Kushtetutës që kërkon ndjekjen e precedentëve të **Strasburgut** dhe vënien në jetë të instrumenteve juridike ndërkombëtare të garantuara me nenin 22 të Kushtetutës. Shikuar në këtë kuptim, hapësira juridiksionale e Gjykatës sa i përket kontrollit të përputhshmërisë së amendamenteve kushtetuese me Kushtetutën është shumëfish më e gjerë sesa që mund të duket në rend të parë. Precedenti i **Strasburgut**, instrumentet ndërkombëtare të komstitucionalizuara dhe precedentet gjyqësore të dhëna gjatë interpretimet të tyre përbëjnë një hapësirë tejet të gjerë në kuadër të së cilës ilën duhet të interpretohet kushtetutshmëria e çdo amendamenti të propozuar kushtetues. Kjo nënkupton se kontrolli i përputhshmërisë së amendamenteve kushtetuese të propozuara me kapitullin II të Kushtetutës përbën një terren që ngërthen në vetvete jo thjeshtë një listë të drejtash dhe lirish të njeriut, por një terren standardesh ndërkombëtare të cilat duhet të shërbejnë si bazë për interpretim të të drejtave dhe lirive kushtetuese dhe të vetë formës së organizimit të pushtetit dhe mënyrës së ushtrimit të tij. Kjo praktikisht nënkupton se çdo interpretim duhet të bëhet duke respektuar germën, frymën dhe shpirtin e **Kushtetutës së Kosovës**, e kuptuar si një tërësi organike e modeluar sipas standardeve të konstitucionalizmit modern. Thënë me fjalë tjera, me kontroll kushtetues të amendamenteve kushtetuese në rastin e Kosovës nënkuptohet kontrolli i kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese ku si parametër kontrollues nuk është vetëm përputhshmëria e tyre me kapitullin II, por me vetë germën, frymën dhe shpirtin i **Kushtetutës.** Në procesin kontekstual të këtij lloji të kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë, Kushtetuta e vitit 2008, kuptohet si një tërësi organike dhe e pandarë që normon një model të konstitucionalizmit liberal perëndimor në secilin aspekt të tij.

Sa i përket çështjes së efektit juridik të vendimit të Gjykatës nëse konstaton mospërputhshmëri në mes të amendamentit të propozuar dhe kapitullit II, përkatësisht germës, frymës dhe shpirtit të Kushtetutës si një tërësi organike e pandarë dhe organike, duhet thënë që neni 113.9 është i ndërtuar në formë të një detyrimi pozitiv që ndalon amandamentimin kushtetues nëse kjo i pakëson të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara në kapitullin II, përkatësisht nëse është në përputhshmëri me germën, frymën dhe shpirtin e Kushtetutës si një tërësi organike dhe e pandarë. **Ky nuk është kuptimi tekstual, por substancialisht dhe thellësisht teleologjik i konstitucionalizmit kosovar.** Në vijim të këtij kuptimi, Kuvendi është i lidhur me vendimin e Gjykatës sa i përket përputhshmërisë së tillë, dhe i ndalohet që t'i procedojë për votim amendamentet e propozuara, të cilat janë konstatuar si të kundërta me parametrat si më sipër të Kushtetutës. As jurisprudenca e Gjykatës nuk është larg këtij kuptimi që e parashtruam këtu sipër. asnjëherë në vendimmarrjen e saj në kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese, Gjykata nuk është mbështetur

[271] Heinz Klug, "South Africa's Constitutional Court: Enabling Democracy and Promoting Law in the Transition from Apartheid." *Journal of Comparative Law* Vol. III Issue 2 (2008) fq. 174- 193; Andea Lollini, "La Corte costituzionale sudafricana". Në Luca Mezzeti, *Sistemi e Modeli di Giustizia Costituzionale*. Tomo I (CEDAM: Padova, 2009) fq. 785-812.

vetëm në kapitullin II të Kushtetutës si parametër të vetëm për vlerësim të përputhshmërisë kushtetuese të amendamenteve kushtetuese, por ka marrë parasysh çdo germë, frymën dhe shpirtin e saj, gjithnjë duke e kuptuar atë si një tërësi të pandarë dhe organike që i shërben një qëllimi të njëjtë. Ai qëllim, siç kemi vërejtur më herët, konsiston në transformimin dhe formatizimin e shoqërisë kosovare në çështjet e organizimit dhe ushtrimit të pushtetit si dhe në çështjet e rolit dhe të pozitës së individit në shoqëri sipas standardeve më të larta të botës liberale perëndimore. Në këtë aspekt, krejt kjo procedurë ka një qëllim të vetëm: që të vejë një ndalesë të rreptë ndaj miratimit në Kuvendin e Kosovës të amendamenteve kushtetuese që nuk janë në përputhje me standardet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, dispozitat kushtetuese mbi formën e qeverisjes dhe mënyrën kushtetuese të ushtrimit të pushtetit në Kosovë.

Deri më tani, në Gjykatën Kushtetuese ka pasur gjithsej shtatë raste në të cilat ka shqyrtuar dhe vendosur kushtetutshmërinë e amendamenteve të propozuara kushtetuese.[272] Në rastin e parë, Aktgjykimi në rastin **KO 38/12**, Gjykata ka vendosur për kushtetutshmërinë e amendamenteve kushtetuese që përfundonin pavarësinë e mbikëqyrur të Kosovës të përcaktuar nga **Plani Ahtisari** i marsit të vitit 2007. Në këtë rast, Gjykata pat gjetur se shumica e tyre nuk cenonin dispozitat e kapitullit II të Kushtetutës, por as dispozitat e kapitullit III dhe vlerat e parimet tjera kushtetuese. Në rastin e dytë, ndërkaq, Gjykata anuloi mbi gjashtëdhjetë për qind (60 %) të amendamenteve të propozuara sepse, si të tilla, binin ndesh më kapitujt II dhe III, si dhe me parimet e vlerat tjera kushtetuese. Më i rëndësishmi nga këto amendamente antikushtetuese është amendamenti dhjetë (10), i cili synonte të ndërpriste mandatin pesëvjeçar (5) të shefit kosovar të shtetit përmes përdorimit të teknikës juridike të amendamentit kushtetues, përkatësisht përmes synimit për konstitucionalizim të raporteve momentale politike që synonin rrëzimin nga posti i Presidentit të Republikës znj. **Atifete Jahjaga**: me aktgjykimin në rastet **K.O. 29/12** dhe **K.O. 48/12**, Gjykata shpalli antikushtetues, siç u tha, mbi gjashtëdhjetë për qind (60 %) të amendamenteve, përfshirë edhe amendamentin dhjetë (10). Ky rast ndryshe njihet si **rasti Jahjaga**, kështu do i referohemi edhe në vijim.

Për rastin e amendamenteve që lidhen me **Gjykatën Speciale** kemi folur më herët, kurse për tjerat mund të flasim vetëm sa për të treguar se caqet e kontrollit kushtetues të amendamenteve kushtetuese meqenëse në përmbajtje nuk kanë ndonjë gjë intriguese që do të duhej të tërhiqte vëmendjen e lexuesit tonë. Caqet e kontrollit të kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese, përkatësisht parametrat e kontrollit nga ana e Gjykatës janë mjaft të gjera. Ata parametra të gjerë, në të gjitha rastet deri më sot, përmblidhen në formulimin si më sipër: gjykata bën vlerësimin e kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese jo duke u bazuar në kuptimin tekstual të neneve 113.9 lidhur me nenin 144.3 që përcaktojnë juridiksionin material të Gjykatës, por duke marrë parasysh tërë tekstin e Kushtetutës së vitit 2008, përkatësisht gërmen, frymën dhe shpirtin e saj. Këto caqe të kontrollit Gjykata i ka krijuar duke interpretuar nenet dy paragrafët e parë të 21 ["Parimet e Përgjithshme"] të kapitullit II ["Të Drejtat dhe Liritë Themelore"] lidhur me nenin 7 ["Vlerat"] të Kushtetutës në dritën e standardeve të precedenteve të **Starsburgut,** të cilat, marrë së bashku, përbëjnë rendin objektiv

[272] *Rasti KO 38/12. Aktgjykim. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së propozimeve të Qeverisë për amendamentimin e Kushtetutës, të dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më datën 12 prill 2012*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.:K 234 /12). Prishtinë, më 15 maj 2012; *Rastet KO 29/12 dhe KO 48/12. Aktgjykim. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së amendamenteve të propozuara kushtetuese nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars dhe 4 maj*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Nr. Ref.:AGJ 284/12. Prishtinë, më 20 korrik 2012; *Rasti K0 61/12. Aktgjykim. Konfirmimi i amendamenteve të propozuara kushtetuese, të paraqitura nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 22 qershor 2012, me shkresën Nr. 04-DO-1095*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.: AGJ303/12. Prishtinë, me 31 tetor 2012; *Rasti KO 09/13. Aktgjykim. Konfirmim i amendamentit të propozuar kushtetues, të paraqitur nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 18 janar 2013, nëpërmjet shkresës Nr. 04-DO-1357.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.: AGJ 367/13. Prishtinë, më 29 janar 2013; *Rasti K0 44/14. Aktgjykim. Vlerësimi i amendamenteve të Kushtetutës të propozuara nga Qeveria, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit te Republikës së Kosovës më 11mars 2014, me shkresën Nr. 04-DO-2186*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.:AGJS98/14. Prishtinë, më 3 prill 2014; *Rasti KO 13/15. Aktgjykim. Vlerësim i një amendamenti të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të propozuar nga pesëdhjetë e pesë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe të referuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 6 shkurt 2015 me shkresën nr. 05-259/D0-179.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 16 mars 2015 Nr. ref.: AGJ 782/ 15; *Rasti K0 26/15. Aktgjykim. Vlerësim i amendamentit të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe referuar me 9 mars 2015 nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, me Shkresën nr. 05-433jDO-318.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.: AGJ 788/15. Prishtinë, me 15 prill 2015.

juridik-kushtetues të Kosovës.[273] Thënë ndryshe, nuk është vetëm kapitulli II dhe III, por krejt vlerat, parimet dhe dispozitat e Kushtetutës së vitit 2008 të kuptuara në praktikën e Gjykatës si një tërësi organike dhe e pandarë që shërbejnë si parametra të kontrollit kushtetues të amendamenteve kushtetuese.[274]

Në vijim diskutojmë kryesisht për **rastin Jahjaga** dhe doktrinën kosovare mbi **amendamentet kushtetuese jokushtetuese**, e parë nga aspekti komparativ që nga lindja, zhvillimi dhe gjendja aktuale e saj. Kjo për faktin se aktgjykimi në **rastin Jahjaga** përbën verdiktin më vëllimor dhe më dinamik me të cilin ka frenuar me shumë sukses, përkundër presioneve brutale ndaj Gjykatës, vënien në jetë të vullnetit bruto të shumicës politike, duke siguruar supremacinë (epërsinë) e Kushtetutës dhe vlerave, parimeve e dispozitave të saj mbi mënyrën e ushtrimit të pushtetit. Në fakt, **rasti Jahjaga** ka vendosur caqet e kontrollit kushtetues në një mënyrë tejet të qartë dhe gjerësisht të shtjelluar duke analizuar secilin aspekt të çështjes së amendamenteve kushtetuese, jo vetëm caqet e kontrollit kushtetues por rolin dhe pozitën e Gjykatës në sistemin kushtetues

---

[273] Kjo qasje e Gjykatës i ngjason **doktrinës gjermane** anti-pozitiviste të trasuar nga **Rudolf Smend**, sipas të cilës kushtetuta përbën një rend objektiv të vlerave që kanë fuqi rrezatuese ndaj tërë rendit juridik. Kjo qasje ka marrë legjitimitetin e vet me rastin e njohur **Lüth** (1958) kur **Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë** konstatoi se liritë dhe të drejtat kushtetuese komandojnë dhe kanë epërsi edhe në marrëdhëniet në mes të personave privat. Ky njihet ndryshe edhe si efekti horizontal i lirive dhe të drejtave kushtetuese. Dy qasjet tjera doktrinare në jurisprudencën gjermane kanë qenë shkolla pozitiviste e **Hans Kelsen**, bazuar në hierarkinë e normave si një nuz-produkt i teorisë së pastër të së drejtës, dhe shkolla shtetërore e **Karl Shmit**, sipas së cilës interesi shtetëror dhe vlerat që ai mishëron në një moment të dhënë kohor, përbëjnë vlerat sublime në frymën e të cilave çdoherë duhen interpretuar normat kushtetuese. Cf. Michaela Hailbronner and Stefan Martini, "The German Constitutional Court". Në Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 356-393 në. fq.358-359 et seq
Në Kosovë ekziston një rast ku Gjykata ka provuar të vejë në dukje efektin horizontal të normave kushtetuese në sferën e lirive dhe të drejtave njerëzore. Këtë e ka bërë në rastin rastin **KI 118/14,** i njohur si rasti **Raiffeisen Bank**. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese ka theksuar rëndësinë e të drejtave kushtetuese në sferën private dhe mundësinë e zbatiumit të tyre të drejtpërdrejtë por vetëm në rast të kolizionit të tyre me një një të drejtë tjetër kushtetuese. Në këtë rast, situate ka qenë kjo: parashtruesi i kërkesës, **Raiffeisen Bank**, ka pohuar cenimin e të drejtave të saj kushtetuese për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe cenimin e të drejtës për pronë. Këto cenime, gjithnjë sipas parashtruesit, kishin ndodhur si pasojë e faktit se gjykatat e rregullta kishin ngatërruar gabimisht konceptin e **kamatë vonesës** me **kamatën ndëshkuese**, dyja këto të normuara me ligjet ish-jugosllave mbi marrëdhëniet e detyrimeve. Kjo kishte ndodhur duke mohuar lirinë kontraktuese të palëve, sipas së cilës palët mund të kontraktojnë lirshëm **kamatëvonesën** me palën tjetër meqë tani Kosova kishte një treg të lirë me pluralizëm të pronës dhe të marrëdhënieve ekonomike. Të gjitha këto pretendime ishin hudhur poshtë nga gjykatat e rregullta, të cilat kishin konstatuar se **kamatëvonesa përbën një çështje ligjore dhe një kategori që mund të kontraktohet në mes të palëve sipas dëshirës, kurse kamata ndëshkuese**, për të cilën parashtruesi mendonte se bëhej fjalë, të cilën e kishte ngatërruar me **kamatëvonesën**, mund të përcaktohej vetëm me kontratë dhe vetëm nëse bëhet fjalë për detyrimet që nuk janë detyrime në të holla. Këto argumente, **Gjykata Kushtetuese** i kishte marrë parasysh dhe kishte konstatuar se parashtruesi nuk kishte argumentuar pretentiomet për shkelje të të drejtave kushtetuese dhe se gjykatat e rregullta në tërësi kishin kryer punën e tyre si duhet. Në fakt, në paragrafin 53, Gjykata ka theksuar si vijon:
"[…] Gjykata pranon se interesat konkurruese që kontestohen në këtë rast janë të rëndësisë së madhe për të dy palët, mund të kenë jehonë dhe ndikim në lirinë dhe pavarësinë e individëve të tjerë dhe mund të prekin të drejtat kushtetuese të palëve private në ndërgjegjësimet civile. Sidoqoftë, një pretendim dhe argument i tillë kushtetues nuk është ngritur as pranë Gjykatës Supreme e as pranë Gjykatës Kushtetuese […]".
Ky rast nuk ka ngritur ndonjë çështje kushtetuese dhe, për pasojë, Gjykata e shpalli si të papranueshëm për shkak se qartazi përbënte një kërkesë të pabazuar. Në këtë rast, Gjykata ka lënë të hapur mundësinë e zbatimit të drejtpërdrejtë dhe horizontal të të drejtave kushtetuese, siç kishte ndodhur në rastin e sipërcekur në **Luth në Gjermani**, por vetëm nëse situata të kishte qenë hipotetikisht e kundërt, pra që qytetari privat të kishte përfituar nga zbatimi i një praktike të vjetërsuar që, ta zëmë, fare nuk njeh lirinë e kontraktimit në mes të palëve. Në këtë rast hipotetik, kontraktuesit privatë do të detyroheshin që të hiqnin në tërësi **kamatat ndëshkuese në bizneset e tyre private që nuk janë kërkesa në të holla. E njëjta gjë do të vlente sikur bankat komerciale të detyroheshin që personave privatë mos t'ua merrnin fare kamatëvonesat në detyrimet e tyre në të holla. Në këto raste do të vinte në shrehje cenimi i të drejtës kushtetuese për mbrojtje të pronës si pasojë e kufizimit të lirisë së kontraktimit dhe disponimit, si dhe dispozitave të tjera kushtetuese që kanë të bëjnë me tregun e lirë dhe marrëdhëniet plurale në te. Cf.** *Rasti KI 118/14.Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Raiffeisen Bank Kosovo J. S. C. Vleresim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 24/2013, te 5 shkurtit 2014*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.:RK777/15. Prishtinë, 9 mars 2015. Paragrafi 53 lidhur me paragrafin 74.

[274] Cf., si vijon: paragrafët 27-31["Shtrirja e vlerësimit kushtetues"] të aktgjykimit në rastin **KO 38/12**; paragrafët 56-72 ["Shtrirja e juridiksionit kushtetues"] të aktgjykimit në rastet **KO 29/12** dhe **KO 48/12**; paragrafët 17-18 ["Shtrirja e shqyrtimit kushtetues"] të aktgjykimit në rastin **K0 61/12**; paragrafët 3-4 ["Hyrja"] & 16-17 ["Shtrirja e konfirmimit kushtetues"] të aktgjykimit në rastin **K0 09/13**; paragrafët 12 ["Procedura në Gjykatë"], 23-29 ["Procedura e vlerësimit kushtetues"],si dhe pikën II të pjesës operative të aktgjykimit në rastin **K0 44/14**; paragrafet 23-24, 67 ["Fushëveprimi i vlerësimit"], si dhe pikën II të pjesës operative të aktgjykimit në rastin **K0 13/15**; dhe paragrafet 26 ["Fushëveprimi vlerësimit"], si dhe pikën II të pjesës operative të aktgjykimit në rastin **K0 26/15**.

kosovar si dhe natyrën juridike të vendimeve të marra në vijim të ushtrimit të juridiksionit nga neni 113.9 lidhur me nenin 144.3 të Kushtetutës së vitit 2008.

Dispozitat e neneve 113.9 dhe 144.3 paraqesin versionin kosovar të doktrinës mbi **amendamentet kushtetuese jokushtetuese**, të asaj që, në teorinë dhe në praktikën kushtetuese komparative, identifikohet me emra të ndryshëm, siç janë: **klauzola e përjetësisë** ("eternity clause"), **dispozitat kushtetuese që nuk mund të ndryshohen** ("unamendable constitutional provisions"), **amendamentet kushtetuese jokushtetuese** ("unconstitutional constitutional amendments"), **dispozitat e rrënjosura në mënyrë absolute** ("absolutely entrenched provisions") etj. Këto dispozita ngërthejnë parime dhe vlera kushtetuese dhe figurojnë lart në mjaft kushtetuta të botës, kurse vetë origjinën e kanë në teorinë e në praktikën gjermane. Vetë koncepti i tyre ka dalë nga mendja e **Karl Shmitit**, në një analizë të tij për legalitetin dhe për legjitimitetin e **Kushtetutës së Vajmarit**. Teoria e praktika gjermane, pas **Luftës së Dytë Botërore**, sërish me sugjerimin e tij, pranoi futjen e këtij koncepti në **Ligjin Themelor të Gjermanisë** (1949).[275]

Po të mos ekzistonin këto dispozita të neneve 113.9 dhe 144.3, të cilat mundësojnë kontrollin abstrakt dhe preventiv (paraprak) të çdo amendamenti kushtetues para se të shkojë për miratim të përfaqësuesi i sovranit, në **Kuvend të Republikës së Kosovës**, një zgjidhje kjo kushtetuese që nuk njihet në shume vende të botës,[276] me një siguri të madhe mund të thuhet se Kushtetuta e vitit 2008 do të ishte ndryshuar me rastin e secilës krizë serioze politike. Mjafton të përmendet këtu se vetëm gjatë vitit 2017, Presidenti i Kosovës dhe disa deputetë të Kuvendit të Kosovës provuan të ndryshonin Kushtetutën përmes ligjit. i pari, **Hashim Thaçi**, për të formuar ushtrinë kosovare, kurse të dytët për të zhbërë **Gjykatën Speciale**. Në dy rastet apeli ishte politik dhe nacionalist, mjaft tërheqës sepse thërriste ndërgjegjen dhe ndjenjat më sublime patriotike të kosovarëve për të themeluar ushtrinë e Kosovës, përkatësisht për të penguar gjykimin e vlerave të luftës së **UÇK**-së. Vendimi në **rastin Jahjaga**, i cili gabimisht sot e kësaj dite cilësohet si **vendimi i Kushtetueses mbi Presidenten**, apo **vendimi që i dha presidentes Atifete Jahjaga mandatin e plotë pesëvjeçar**,[277] e që diskutohet në vijim, në esencë nuk është ndryshe nga vendimi të cilin me siguri që do ta merrte Gjykata në rast se do të votoheshin ndryshimet kushtetuese me një ligj të zakonshëm siç pretendohej nga akterët e mësipërm në dy

---

275 Këtu bëhet fjalë për nenin 79.3 të **Ligjit Themelor të Republikës Federale të Gjermanisë**, i cili parasheh si vijon:
"[Amendamentimi i Ligjit Themelor]: (1) Ky Ligj Themelor mund të amendamentohet vetëm me një ligj, i cili në mënyrë shprehimore amendamenton ose plotëson tekstin e tij. Në rastet e traktatit ndërkombëtar mbi paqen, përgatitjen e paqes, përfundimin gradual të një regjimi okupues, apo kur skicohet promovim i mbrojtjes së Republikës Federale të Gjermanisë, mjafton nëse thuhet se dispozitat e Ligjit Themelor nuk përjashtojnë lidhjen dhe hyrjen në fuqi të një traktati të tillë ndërkombëtar dhe ky sqarim kësisoj futet në tekstin e ligjit të ri që amendamenton Ligjin Themelor; (2) Çdo ligj i tillë miratohet me dy të tretat e anëtarëve të **Bundestagut** dhe dy të tretat e votave të **Bundesratit**; (3) Nuk lejohen amendamentet e Ligjit Themelor që prekin ndarjen e Federatës në lande, pjesëmarrjen e landeve në procesin legjislativ, si dhe ato që kanë të bëjnë me parimet e cekura në nenet 1 dhe 20".
Përveç **Gjermanisë**, dispozita të tilla ka gjithandej në **Evropë** (**Norvegjia**, **Italia**, **Franca**, **Turqia**), në **Afrikë** (**Afrika e Jugut**, **Maroku**), në **Azi** (**Arabia Saudite**, **Irani**, **India**), në **Amerikë Latine** (**Kili** etj.).

276 Kontrolli preventiv, si në rastin e Kosovës, është i rrallë dhe ekziston vetëm në disa vende, siç janë **Azerbajxhani, Kirgistani, Moldavia**, **Turqia** dhe **Ukraina**. Cf. analizën komparative të **Komisionit të Venecias** në European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Report on Constitutional Amendment*. Adopted by the Venice Commission at Its Plenary Session (Venice, 11-12 December 2009). *CDL-AD (2010) 001. Study No. 469/2008* (Starsbourg, 19 January 2010). Në internet: www.venice.coe.int (shikuar në dhjetor 2018); Për aspektet teorike të kontrollit preventiv të amendamenteve kushtetuese, cf. Kemal Gozler, *Judicial Review of Constitutional Amendmenets. A Comparative Study* (EKIN PRESS: Bursa, 2008); Gary Jeffrey Jacobsohn, "An unconstitutional constitution? A comparative perspective" *International Journal of Constitutional Law* Vol. 4 no. 3 (July 2006); Yaniv Roznai, "The Theory and Practice of 'Supranational' Limits on Constitutional Amendments". *International and Comparative Law Quarterly.* Vol. 62 Issue 03 (July 2013) fq. 557 597; Yaniv Roznai, "Unconstitutional Constitutional Amendments - The Migration and Success of a Constitutional Idea". *The American Journal of Comparative Law.* Vol. 61, No. 3 (Summer 2013), pp. 657-719; Yaniv Roznai, *Unconstitutional Constitutional Amendments: A Study of the Nature and Limits of Constitutional Amendment Powers*. **The London School of Economics and Political Science.** A thesis submitted to the Department of Law of the London School of Economics for the degree of Doctor of Philosophy. London, February 2014; Joel Colón-Ríos, "Introduction: The forms and limits of constitutional amendments". *International Journal of Constitutional Law* Vol. 13 No. 3 (2015), fq. 567–574.

277 "Zgjedhjet e parakohshme presidenciale varen nga Jahjaga", gazeta e përditshme "**Koha Ditore**", 7 korrik 2012, e shtunë, fq. 1 dhe 3; "Jahjaga: Mirupafshim në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016", gazeta e përditshme "**Bota Sot**", 7 korrik 2012, e shtunë, fq. 1 dhe 4-5; "Foli Kushtetuesja: Presidentja ka mandat pesëvjeçar", gazeta e përditshme "**Epoka e Re**", 7 korrik 2012, e shtunë, fq. 1 dhe 4-5; "Presidente e plotë", gazeta e përditshme "**Express**", 7 korrik 2012, e shtunë, fq. 1 dhe 4-5; "Jahjaga edhe katër vjet presidente", gazeta e përditshme "**Zëri**", 7 korrik 2012, e shtunë, fq. 1-2.

rastet, gjithnjë me supozimin së këto ligje me të cilat do të synohej amendamentimi i Kushtetutës së vitit 2008 do të përfundonin në Gjykatë. Të shohim, pra, në vija të trasha, se cila është forma dhe përmbajtja e vendimit në rastin **rasti Jahjaga**.

Vendimi në fjalë është vendim meritor dhe, për pasojë, ka formën e aktgjykimit. Si i tillë, ai paraqet përgjigjen meritore të Gjykatës, në kuadër të juridiksionit të bazuar në nenin 113.9 lidhur me nenin 114.3 të Kushtetutës. Ky juridiksion, në rastin konkret që shtjellohet këtu dhe që ka qenë objekt i Aktgjykimit, ka të bëjë me kontrollin kushtetues abstrakt dhe preventiv (paraprak) të 11 (njëmbëdhjetë) propozim-amendamenteve në Kushtetutën e Kosovës. Ato mbajnë autorësinë e një të katërtës (1/4) së deputetëve të Kuvendit, **por që në aspektin formal detyrimisht dorëzohen në Gjykatë për kontroll kushtetues nga kryetari i Kuvendit,**[278] gjë që nuk nënkupton se kryetari i Kuvendit ka autorizim kushtetues për të draftuar (propozuar) amendamente kushtetuese.[279] Sipas nenit 144 (1) të Kushtetutës, krahas dy organeve tjera kushtetuese, për propozim të amendamentimit kushtetues kërkohet së paku një e katërta (1/4) e numrit të deputetëve, pra së paku tridhjetë (30) deputetë. Komisioni kushtetues nuk paraqet një palë të autorizuar kushtetuese për propozimin e amendamenteve në Kushtetutën e Kosovës.[280]

Aktgjykimi në **rastin Jahjaga** ka mbi dyzet faqe, me 276 paragrafë, pa llogaritur këtu pjesën e tij operative (dispozitivin). Ky i fundit ka pesë paragrafë përmbajtjesorë. Përkundër këtij vëllimi, në diskursin publik të sforcuar njëanshëm nga **LDK**-ja, si parti opozitare në kohën e dhënies së aktgjykimit, dhe nga një pjesë e anëtarëve të Komisionit kushtetues, është goditur dhe është përfolur vetëm dispozita e paragrafit 255 të tij.[281] Gjykata vuri në pah, në këtë paragraf, se pritjet e qytetarëve të Kosovës nuk janë ato që buronin nga marrëveshja politike me të cilën, **inter alia,** kërkoheshin zgjedhjet e parakohshme, por ato që buronin nga vendimi i Kuvendit për zgjedhjen e presidentes **Jahjaga** (për pesë vjetët e ardhshme). Gjykata i dha përparësi absolute pritjeve të qytetarëve që burojnë nga një vendim i një trupi kushtetues, Kuvendi i Kosovës, i cili zgjodhi znj. Atifete Jahjaga presidente të Kosovës.[282] Pritjet e tilla të qytetarëve të Kosovës janë transcendente dhe mbijetojnë konjukturat momentale politike, të cilat i ka pasur parasysh marrëveshja politike. Pritjet, të cilat i njeh Aktgjykimi, lidhen me rolin dhe me pozitën e presidentit të Kosovës si përfaqësues legjitim i vendit, brenda e jashtë, dhe si garantues i funksionimit demokratik të institucioneve kushtetuese të Kosovës. Kjo është fryma e letra e Kushtetutës. Kontestimi i fuqisë së Aktgjykimit, në këtë pjesë, u bë në mënyrë krejt të thjeshtëzuar, me fjalë e me argumente që aspak nuk kanë të bëjnë me teorinë dhe me praktikën kushtetuese të vendeve perëndimore, të atyre vendeve që **Kosova** dhe kushtetuta e saj i synojnë pa asnjë dyshim.

Paragrafët 247-271 të Aktgjykimit, që kanë të bëjnë me **Presidentin e Republikës**, sikundër dhe pjesët e tjera, kanë një arsyetim të gjatë e profesional. Aty shtjellohet roli, pozita dhe rëndësia e shefit të shtetit, si garantues dhe si personifikim i unitetit juridiko-kushtetues dhe shtetëror i tërë shoqërisë kosovare (e

---

278 Neni 144. 3 ["Amendamentimi"] i Kushtetutës: "3. Ndryshimet në këtë Kushtetutë mund të miratohen nga Kuvendi vetëm pasi të ketë adresuar Kryetari i Kuvendit të Kosovës amendamentin e propozuar në Gjykatën Kushtetuese për ta vlerësuar paraprakisht nëse ndryshimi i propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës".

279 Për mendim ndryshe, cf. Dren Doli & Fisnik Korenica, "Kosovar Constitutional Court's Jurisdiction: Searching for Strengths and Weaknesses", fq. 831-832 (autorët besojnë gabimisht se vetëm kryeparlamentari, jo Kuvendi, ka autorizim autonom kushtetues për të propozuar, përkatësisht për të draftuar amendamente kushtetuese).

280 Neni 144.1 i Kushtetutës (Amendamentimi): "Qeveria, Presidenti ose një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit, sipas Rregullores së punës të Kuvendit, mund të propozojnë ndryshime dhe amendamentime të kësaj Kushtetute".

281 Paragrafi 255 i aktgjykimit në rastet **K.O. 29/12** dhe **K.O. 48/12**: "Në rastin e Presidentes aktuale të Republikës, kjo do të thotë që i gjithë populli i Kosovës pret që ajo të jetë Presidentja e tyre gjatë pesë (5) vjetëve të ardhme. Kështu që, shkurtimi i mandatit të saj, siç propozohet me amendamentin dhjetë (10), e privon popullin e Kosovës nga përfaqësuesi i tyre legjitim dhe garantuesi në një kohë më të hershme se që besonin dhe shpresonin".

282 Më 2 tetor 2012, në emisionin **Rubikon** të **KTV**-së, shefi i **LDK**-së, **Isa Mustafa**, deklaroi se "të gjithë e kemi ditur kur kemi lidhur marrëveshjen politike se dispozitat e saj janë antikushtetuese, sepse mandati i **Presidentit të Kosovës** është pesë (5) vjet". Z. Mustafa tha se nuk sheh asgjë të keqe në aktgjykimin e Gjykatës në këtë drejtim. Ajo që kontestoi **Isa Mustafa**, në këtë paraqitje publike, kishte të bënte me faktin se "Gjykata duhet ta dijë se krejt Kosova e ka pasur të qartë se me marrëveshje politike ne jemi dakorduar që znj. Jahjaga të ketë mandat të përkohshëm dhe jo mandat pesëvjeçar", emisioni "**Rubikon**", me **Adriatik Kelmendin**, në programin televiziv të **KTV**-së, 2 tetor 2012 (ora 20:00).

kuptuar si shtet sovran dhe i pavarur). Esenca e diskursit kontestues, krejtësisht politik, mëtonte t'i tregonte publikut kosovar se, ndër të tjera, "presidentja Atifete Jahjaga nuk përfaqëson popullin e Kosovës dhe, për pasojë, Gjykata nuk ka mundur ta dijë se kush është përfaqësues politik i popullit të Kosovës".[283] Përveç ndaj këtij paragrafi, në asnjë moment nuk ka pasur kritikë ndaj pjesëve të tjera të Aktgjykimit. Gjykata nuk ka thënë, në asnjë paragraf, e aq më pak në paragrafin 255, se presidentja **Jahjaga** përfaqëson **unitetin politik të popullit.** Ky nuk është ndonjë zbulim, meqë dihet botërisht se ish-presidentja **Atifete Jahjaga** asnjëherë nuk ka përfaqësuar ndonjë forcë politike. Edhe po të ishte se ajo përfaqëson një forcë të caktuar politike, **nuk është punë e Gjykatës të merret me aspektet e përfaqësimit të unitetit sociologjik dhe politik të popullit nga shefi i shtetit kosovar**. Kjo do të përbënte një absurd **par exellence** për sistemin presidencial të tipit të **ShBA**-së, ku shefi i shtetit ka forcë ekzekutive dhe përfaqëson maksimalisht mesataren e qytetarëve amerikanë, e lëre më për demokracinë kushtetuese parlamentare të tipit të Kosovës.

Sikundër që mund të jetë vërejtur nga shtjellimet e mësipërme, gjeneza e këtij diskursi të vetëmbyllur buron nga dinamikat e brendshme politike në Kosovë, të cilat u krijuan dhe u zhvilluan pas arritjes së marrëveshjes politike të datës 6 prill 2011, si dhe nga vetë kushtet e parapara aty. Mbi bazën e atyre kushteve, nuk ka asnjë dyshim, u përpiluan 11 (njëmbëdhjetë) amendamentet e propozuara në Kushtetutën e vitit 2008. Këto amendamente kanë qenë objekt i vlerësimit abstrakt dhe preventiv (paraprak) nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Se amendamentet e propozuara mishëronin frymën dhe germën e marrëveshjes politike, vërehet jo vetëm nga mënyra e formulimit të amendamentit, me të cilin synohej shkurtimi i mandatit pesëvjeçar të shefit të shtetit kosovar të kohës, znj. **Atifete Jahjaga,**[284] por edhe nga formulimi i amendamentit tjetër, që synonte kufizime drastike dhe irracionale të kompetencave të ushtruesit të detyrës së Presidentit, në rastet kur kjo pozitë do të ushtrohej nga kryetari i Kuvendit. Edhe këto amendamente, Gjykata i vlerësoi me të drejtë si jo kushtetuese, sepse

---

283 Debati në fillim u nis me fjalët e thjeshta e pa asnjë përmbajtje, se "vendimi i Gjykatës nuk është profesional". Ky lloj "diskutimi" ka vazhduar me një intensitet mjaft të madh që nga dita e nxjerrjes së vendimit dhe ende aty-këtu synon të mbahet "gjallë" nga Komisioni kushtetues. Në publik, dhe në qarqet akademike, nuk ka pasur asnjë debat në përkrahje të një qasjeje të tillë të thjeshtëzuar ndaj vendimit në fjalë. Ndonjë përkrahje aty-këtu ka qenë nga laikët dhe nga publicistika kosovare, pa asnjë vlerë shkencore. Cf. "Kryetari i Komisionit kushtetues, Arsim Bajrami, konteston vendimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me amendamentet për zgjedhjen e presidentit", gazeta e përditshme "**Koha Ditore**", 7 korrik 2012, e shtunë, fq. 1 dhe 3; "Kuvendi me Rezolutë antikushtetuese", gazeta e përditshme "**Koha Ditore**", 8 korrik 2012, e diel, fq. 1 dhe 3; Riza Smaka, "Vendimi ka qenë korrekt", gazeta e përditshme "**Epoka e Re**", 9 korrik 2012, e hënë, fq. 7; "LDK ndihet e tradhtuar nga Thaçi, AKR shpreson në vullnetin e presidentes", gazeta e përditshme "**Koha Ditore**", 10 korrik 2012, e martë, fq. 2; "Kushtetuesja: I gjithë populli shpreson ta ketë Jahjagën 5 vjet në krye", gazeta e përditshme "**Koha Ditore**", 21 korrik 2012, e shtunë, fq. 3; Halil Matoshi, "Populizmi kushtetues dhe Zarifja", gazeta e përditshme "**Koha Ditore**", 25 korrik 2012, e mërkurë, fq. 10; Sokol Bylykbashi, "Kushtetuesja politike", gazeta e përditshme "**Tribuna Shqiptare**", 19 gusht 2012, e mërkurë, fq. 13; "Gjykata Kushtetuese dhe Komisioni për ndryshime kushtetuese përplasen për amendamentet që i referohen presidentit", gazeta e përditshme "**Koha Ditore**", 29 gusht 2012, e mërkurë, fq. 1 dhe 3; "E godasin Gjykatën", gazeta e përditshme "**Express**", 29 gusht 2012, e mërkurë, fq. 6; "Kuvendi në hall me amendamentet jokushtetuese", gazeta e përditshme "**Koha Ditore**", 11 gusht 2012, e shtunë, fq. 1 dhe 3.

284 Ka pasur dy versione të amendamenteve të propozuara: versioni A dhe versioni B. Këtë cilësim të këtyre propozimeve e ka bërë vetë Gjykata, për qëllimet e lehtësimit të punës së saj. Për qëllimet e dhënies së drejtësisë kushtetuese, ndërkaq, këto dy propozime fare nuk kanë rëndësi. Kjo, nga shkaku se Aneksi A flet për "brenda gjashtë muajsh", kurse versioni B për "pas gjashtë muajsh", kohë kur amendamenti që shkurtonte mandatin e presidentes aktuale duhej të hynte në fuqi dhe, për pasojë, të organizoheshin zgjedhjet e reja. Versioni i parë përsërit **ad literam** urdhrin politik të marrëveshjes së sipërcekur politike. Kjo marrëveshje parashikonte mbajtjen e zgjedhjeve "jo më vonë se gjashtë muaj nga dita e hyrjes në fuqi të ndryshimeve të nevojshme kushtetuese dhe ligjore". Versioni B, po ashtu, përçonte një urdhër politik të qartë, i cili ishte kristalizuar ndërkohë nga liderët politikë kosovarë, nënshkrues të marrëveshjes së sipërcekur politike të datës 6 prill 2011. Tash, me këtë version, sikur tregohej një lloj "mëshire" për mandatin kushtetues (pesëvjeçar) të presidentes kosovare, sepse parashihte zgjedhjet e drejtpërdrejta pas "gjashtë muajsh" nga dita e hyrjes në fuqi të amendamenteve të propozuara kushtetuese që i rrëzoi Gjykata. Esenca e Aktgjykimit qëndron në atë se ai pastroi dilemat e atyre që besonin se mund të përdornin Gjykatën Kushtetuese të Kosovës për **konstitucionalizimin** e një marrëveshjeje politike të krijuar në mënyrë jashtëkushtetuese. Ky **konstitucionalizim**, po të pranohej nga Gjykata, nënkuptonte rrëzimin e menjëhershëm në mënyrë jokushtetuese të shefit kosovar të shtetit nga posti që mbante. Gjykata tha, për të qenë më i qartë, se presidentja e kohës, **Atifete Jahjaga**, nuk mund të shkarkohej nëpërmjet amendamenteve kushtetuese, që kanë bazë në një marrëveshje politike konjukturale të datës 6 prill 2001 në mes të liderve të forcave politike kosovare, në asnjë kohë para mbushjes së katër (4) vjet e treqind e gjashtëdhjetë e pesë (365) ditë. Nuk ka rëndësi nëse fjala është "brenda" apo "pas gjashtë muajsh", siç përcaktohej me marrëveshjen politike të datës 6 prill 2011 për rrëzimin e presidentes Atifete Jahjaga, të shndërruar në amendamentin dhjetë (10) si më sipër.

zvogëlonin të drejtat dhe liritë e parapara me Kapitullin II të Kushtetutës.[285] Të shohim pak si duket përgjigja e Gjykatës në këtë kufizim irracional.

Në nenin 90.5 (2,3,6) të Kushtetutës, u propozua amendamenti 7 (shtatë), i cili thoshte se **ushtruesi i detyrës së Presidentit** duhet të jetë i kufizuar në ushtrimin e të gjitha kompetencave dhe të funksioneve të Presidentit, në veçanti ato që kanë të bëjnë me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, me emërimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve, si dhe me kompetencën për dhënien e faljeve individuale. Arsye e këtyre kufizimeve të çuditshme, të cilat fare nuk mund të futen në kornizën e teorisë edhe të praktikës së konstitucionalizmit perëndimor, duhet kërkuar, sërish si në rastin Jahjaga, në dinamikat dhe konjukturat momentale politike të kohës që i kanë pararendur arritjes së marrëveshjes politike më datën 6 prill 2011. Hartuesit e këtij amendamenti i kanë pasur parasysh faktorët **ad hominem,** përkatësisht vlerësimin të cilin aktorët kryesorë politikë ia kanë bërë punës dhe sjelljes së ushtruesit (dy herë me radhë) të detyrës së presidentit të Kosovës, **Jakup Krasniqi**. Ky vlerësim i referohet kohës prej shtatorit të vitit 2010 e deri në prill të vitit 2011, kur J. Krasniqi pat ushtruar detyrën e presidentit të Kosovës. Në këtë kohë, ai pat refuzuar emërimin e një numri të caktuar të gjyqtarëve e të prokurorëve, pat dhënë një numër të madh të faljeve individuale, pat ndarë medalje, mirënjohje e çmime, të cilat qenë kritikuar publikisht mjaft ashpër nga segmente të caktuara të shoqërisë kosovare.[286] E, megjithatë, vlen të thuhet se këto kritika kanë qenë kryekëput politike, sepse nuk ka pasur një procedurë apo një vlerësim ligjor të kryer me kompetencë, ku do të kontestohej ligjshmëria apo kushtetutshmëria e punës dhe e sjelljes së ish-ushtruesit të detyrës së Presidentit të Kosovës për këtë periudhë. Gjykata Kushtetuese nuk ka guxuar t'i marrë për bazë argumentet **ad hominem** në procedurën e kontrollit abstrakt dhe preventiv (paraprak) të normës kushtetuese të përmbajtur në propozim-amendamentin 7 (shtatë). Në fakt, Gjykata nuk guxon ta bëjë një gjë të tillë në asnjë procedurë që zhvillohet para saj.

Cilësia themelore e kontrollit abstrakt të normës juridiko-kushtetuese konsiston në atë se aty bëhet vlerësimi i efektit të përgjithshëm dhe hipotetik të normës kundrejt çdo situate apo rrethane në të cilën dikush mund të ndodhet në të ardhmen. Gjykata, pra, për dallim nga politika, abstrahon se kush ka qenë, kush është, apo kush mund të jetë ushtrues i detyrës së **Presidentit të Republikës**, dje, sot, dhe në të ardhmen. Ai sërish mund të jetë **Jakup Krasniqi**. Kjo nuk ndryshon asgjë. Në rastet e kontrollit abstrakt dhe preventiv (paraprak) të normës kushtetuese, kjo bie më shumë në sy. Ky kontroll, siç u theksua, bëhet në fillim në raport me kapitullin II të Kushtetutës, përkatësisht ka për qëllim vlerësimin nëse amendamenti i propozuar zvogëlon të drejtat dhe liritë nga Kapitulli II i Kushtetutës. Edhe kapitulli II i Kushtetutës, i cili shërben vetëm si pikë themelore dhe nisëse e referimit me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së amendamenteve të propozuara, vlerësohet në mënyrë abstrakte. Kjo do të thotë se Gjykata ka vlerësuar **in abstracto** që çdo kufizim i sotshëm i kompetencave të ushtruesit të detyrës së Presidentit, siç është synuar nga hartuesit e propozim-amendamentit në fjalë, cenon çdo herë dhe ndaj çdokujt të drejtat dhe liritë nga kapitulli II i Kushtetutës, dhe atë, për sa vijon:

- në rastin e gjendjes së jashtëzakonshme, potencialisht paralizon shtetin dhe krijon krizë kushtetuese, pra krijohet një ambient ku vihen në rrezik të drejtat dhe liritë e njeriut;[287]
- kur bëhet fjalë për emërimet e për shkarkimet e gjyqtarëve, një kufizim i tillë pengon administrimin e drejtësisë dhe, për pasojë, pakëson të drejtat e liritë e njeriut nga kapitulli II i Kushtetutës në sensin që qytetarët dhe subjektet e tjera të së drejtës nuk kanë mundësi t'i

[285] Paragrafi operativ III (pikat 3 deri 5) të aktgjykimit në rastin **K.O. 29/12** dhe **K.O. 48/12.**

[286] Cf. Kuvendi i Republikës së Kosovës. Lajmet e fundit: "Reagim i Kabinetit të Kryetarit të Kuvendit", 20 shkurt 2012, e hënë, ueb-faqja e Kuvendit të Kosovës: http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,128,4462 (shikuar më 24 nëntor 2017); "Eliminuan nga lista Driton Muharremin", gazeta e përditshme **Kosova sot**, 27 janar 2012, e premte, vetëm në version elektronik": http://www.kosova-sot.info/politike/kosove/eliminuan-nga-lista-driton-muharremin (shikuar në nëntor 2017). Këtu, në këtë shkrim, analizohet raporti kritik i **Misionit të OSBE**-së në Kosovë, i cili flet për parregullsitë në emërimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve të Kosovës nga ushtruesi i detyrës së Presidentit, **Jakup Krasniqi.**

[287] Cf. Paragrafët 158-161 të aktgjykimit në rastet **K.O. 29/12** dhe **K.O. 48/12.**

realizojnë me rrugë gjyqësore të drejtat dhe liritë e tyre;[288]

- për sa i takon faljeve individuale, pengimi i ushtruesit të detyrës së Presidentit për të bërë shpalljen e faljeve individuale të atyre që janë të privuar nga liria, paraqet cenim absolut të të drejtave dhe të lirive njerëzore, sepse qytetarët që kanë të drejtë për një falje të tillë privohen nga ushtrimi dhe nga gëzimi i fryteve të faljes derisa vendi të zgjedhë presidentin e ri, përkatësisht derisa **Kosova** ka një ushtrues të detyrës së **Presidentit të Republikës.**

Sikundër vërehet nga kjo paraqitje e përciptë, Gjykata nuk ka marrë parasysh asgjë tjetër, përveç analizimit **in abstracto** të normës kushtetuese të propozuar me amendament kundrejt kapitullit II të Kushtetutës. Në këtë lloj të kontrollit kushtetues shpërfillen në tërësi ngjarjet dhe personat që ndërlidhen **in concreto** me ushtruesin e detyrës së Presidentit. Kush ka qenë, kush është dhe kush mund të jetë ushtrues detyre i Presidentit, si dhe kush mund të përfitojë, apo të dëmtohet, nga veprimet apo nga aktet e ushtruesit të detyrës së Presidentit, nuk çon peshë fare dhe nuk merret parasysh me rastin e ushtrimit të këtij lloji të juridiksionit kushtetues nga Gjykata. Po ashtu, fuqishëm duhet të vihet në dukje fakti se, me rastin e kontrollit abstrakt dhe preventiv (paraprak) të normës kushtetuese, Gjykata nuk guxon të marrë parasysh **travaux preparatoirs** (punimet përgatitore), të cilat kanë çuar në hartimin e propozim-amendamenteve, të cilat janë objekt i kontrollit abstrakt dhe preventiv (paraprak) kushtetues. Si punime përgatitore, në rastin që diskutojmë këtu, kanë qenë bisedimet politike, kryesisht diskrete, ndërmjet liderëve politikë dhe të cilat kanë rezultuar me arritjen e marrëveshjes politike të datës 6 prill 2011. Nuk ka asnjë dyshim se, nga analiza e tekstit të amendamenteve të propozuara dhe nga krahasimi i tyre me tekstin e marrëveshjes politike, del që hartuesit e amendamenteve kanë synuar **të konstitucionalizojnë**, përkatësisht të kontrabandojnë, një vullnet momental politik të nënshkruesve të marrëveshjes politike dhe ta shkrijnë atë vullnet në tekstin e ri të Kushtetutës së vitit 2008. Kjo formë e ushtrimit të pushtetit konstitutiv, pra e vullnetit të popullit si sovran, nuk ka mundur të pranohet nga Gjykata, sepse është tërësisht në kundërshtim me parimet bazë të konstitucionalizmit modern. Në kuadrin e këtyre parimeve bazë, karta për të drejtat dhe për liritë kushtetuese të subjekteve të së drejtës, kapitulli II i Kushtetutës, paraqet një shtyllë tejet të rëndësishme, e cila mbështet dhe legjitimon ushtrimin e këtij vullneti konstitutiv të popullit, i kuptuar si sovran.[289] Do të ishte lëshim serioz dhe skandal profesional i llojit të vet, sikur Gjykata t'i kishte marrë parasysh **travaux preparatoirs,** të cilat kanë rezultuar me arritjen e marrëveshjes politike më datën 6 prill 2011, pra sikur të kishte **konstitucionalizuar** dispozitat e saj **post festum**. Kjo është kështu, në veçanti, nëse kihet parasysh se, në Kosovë, për dallim nga shumë vende të tjera, nuk ka dallim ndërmjet Kuvendit, **si organ ligjvënës**, dhe Kuvendit, si **organ kushtetutëbërës.**[290] Me një fjalë,

---

[288] Cf. Paragrafët 162-167 të aktgjykimit në rastet **K.O. 29/12** dhe **K.O. 48/12.**

[289] Në disa kushtetuta, ushtrimi i pushtetit konstitutiv (**pouvoir constituant**) ka një formë e procedurë krejt të strukturuar dhe është i ndarë nga **procedura e amendamentimit të zakonshëm**, siç ekziston në rastin e Kosovës: në disa raste raste kur kërkohet konvokimi i një asambleje të veçantë kushtetuese për këtë qëllim (**Bullgaria**) kurse në disa të tjera kërkohet që të bëhet propozim-amendamentimi dhe të shpërndahet organi përfaqësues e të krijohet një tjetër, i cili pas leximit tjetër vendos për miratimin ose jo të tyre (**vendet skandinave**), duke i lënë hapësirë të mjaftueshme debatit publik për amendamentet e propozuara. Përveç këtyre, në praktikë ekzistojnë raste kur parashikohen intervale të gjata kohore ndërmjet propozimit të amendamenteve dhe miratimit të tyre në organin përfaqësues (**Estonia, Lituania, Mali i Zi** etj.). Cf. më shumë për këtë në Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Report on Constitutional Amendment*; për aspektet teorike të të gjitha modaliteteve të amendamentimit kushtetues, Cf. Carlo Fusaro, "Changing Constitutions" Në Dawn Oliver and Carlo Fusaro (eds), *How Constitutions Change. A Comparative Study*, fq. 3-6; Dawn Oliver and Carlo Fusaro, "Changing Constitutions: Comparative Analysis". Në Dawn Oliver and Carlo Fusaro (eds), *How Constitutions Change. A Comparative Study*, fq. 381-403; Carlo Fusaro and Daën Oliver, "Towards a Theory of Constitutional Change". Në Dawn Oliver and Carlo Fusaro (eds), *How Constitutions Change. A Comparative Study,* fq. 404-433.

[290] **Izraeli** është një tjetër vend ku nuk bëhet dallimi në mes të asamblesë konstitutive dhe asaj legjislative. Megjithatë, ekziston një dallim në mes të **Kosovës** dhe **Izraelit** në sensin që në Izrael **Kneset**-i (parlamenti izraelit) e ka të njohur nga tjerët rolin e kujdestarit të vullnetit origjinal të popullit hebre, në veçanti kur është fjala për ruajtjen e demokracisë hebreje. Edhe atje, sidoqoftë, **Kneset**-i ka fuqi të kufizuar për sa i përket ushtrimit të pushtetit konstitutiv në emër të krejt hebrenjëve dhe ndyshimit të vetë natyrës së demokracisë hebreje. Cf. më shumë për këtë tek: Ahron Barak, "Unconstitutional Constitutional Amendements". *Israel Law Review* Vol. 44 No. 3 (2012); Sharon Weintal, "The Challenge of Reconciling Constitutional Eternity Clauses With Popular Sovereignty: Toward Three-Track Democracy in Israel as a Universal Holisitic Constitutional System and Theory". *Israel Law Review* Vol. 44 No. 3 (2012).

amendamentimi kryhet nga i njëjti kuvend, me dy të tretat (2/3) e anëtarëve të tij, përfshirë dy te tretat (2/3) e votave të deputetëve të cilët mbajnë vende të garantuara. Në një situatë të tillë, kushtetutëbërësit origjinalë kosovarë kanë vendosur t'i japin Kapitullit II rolin e pikës së referimit bazë për ta matur shkallën dhe formën e konstitucionalizmit kosovar në rastet kur dikush synon të bëjë ndryshimin e tekstit origjinal të Kushtetutës. Në kushtet e globalizimit aktual, me të drejtë është vërejtur në doktrinë se, e drejta ndërkombëtare, në veçanti pjesa e saj që ka të bëjë me të drejtat e njeriut, luan një rol të veçantë në vlerësimin kushtetues të amendamenteve kushtetuese.[291] Kjo është kështu, në veçanti në **Evropë**, pjesë e së cilës është **Kosova**, e cila, në nenin 53 të Kushtetutës së saj, pra brenda kapitullit II, i jep fuqi dhe vend të veçantë **KEDNJ**.[292] Përmes korpusit të lirive dhe të drejtave njerëzore, siç u tha më herët, parametri për kontroll kushtetues fiton një hapësirë tjetër shumë më të gjerë dhe përfshin krejt formën e organizimit dhe mënyrën e ushtrimit të saj, parametër që praktikisht përfshin çdo germë, frymën dhe shpirtin e Kushtetutës së vitit 2008, e kuptuar si një tërësi e pandarë dhe organike.

Amendamentet kushtetuese, derisa nuk janë votuar, i nënshtrohen kontrollit kushtetues për të parë nëse bien ndesh me tekstin origjinal të Kushtetutës marrë në tërësinë e tij. Në momentin e miratimit të tyre, ato bëhen pjesë e barabartë me pjesët origjinale (fillestare) të tekstit kushtetues. Për këtë arsye, në teorinë dhe në praktikën kushtetuese parashihen kufizime te theksuara procedurale dhe materiale (substanciale) në ushtrimin e fuqisë (pushtetit) konstitutive (krijuese) të popullit, i kuptuar si sovran (**pouvoir constituant**). Amendamentimi paraqet një ndër këto fuqi (pushtete) krijuese. Kjo çështje ka rëndësi të ritheksohet këtu, me rastin e analizimit të vlerësimit të punës së Gjykatës në kontrollin e kushtetutshmërisë së amendamentit 10 (dhjetë), të cilës i kthehemi sërish në vijim.

Në këtë rast, pra në **rastin Jahjaga**, Gjykata deri në fund ka pasur parasysh kriteret profesionale të drejtësisë kushtetuese dhe të konstitucionalizmit modern perëndimor. Kjo do të thotë se Gjykata, në asnjë rast, nuk ka çarë kokën për kriteret dhe për kushtet e parapara në tekstin e marrëveshjes politike. Në paragrafët 247-271 të Aktgjykimit, në mënyrë shumë abstrakte flitet për çdo situatë apo për çdo gjendje në të cilën mund të gjendet secili person në cilësinë e Presidentit të Kosovës, sot dhe në të ardhmen, përkatësisht se ai/ajo mund të mënjanohet nga detyra vetëm nëpërmjet mënyrës së paraparë kushtetuese. Gjykata ka treguar, njësoj sikur Gjykata Supreme e Indisë, se "e drejta për amendamentim nuk nënkupton të drejtën për rrënim".[293] Ky është standardi matës i çdo demokracie kushtetuese. Çdo rrugë tjetër, si kjo që synohej nëpërmjet amendamentit 10 (dhjetë) (neni i ri i propozuar ka qenë neni 162.1), cenon vetë esencën, rolin dhe pozitën e shefit të shtetit në një republikë demokratike parlamentare, pra të një institucioni që personifikon unitetin juridiko-kushtetues të popullit dhe garantuesin e funksionimit demokratik të institucioneve kushtetuese shtetërore.[294] E, shikuar nga këndvështrimi i kapitullit II, sërish **in abstracto,** pra pa marrë parasysh se kush është dhe pse është sot shef i shtetit kosovar, kjo mënyrë e synuar për mënjanimin e kreut të shtetit cenon të drejtat zgjedhore (aktive dhe pasive),[295] ndarjen e

---

[291] Cf. më shumë në Lech Garlicki and Zofia A. Garlicki, "External Review of Constitutional Amendments? International Law as a Norm of Reference". *Israel Law Review*, Vol. 44, No. 3 (2012).

[292] Neni 53 ["Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut"] të Kushtetutës: "Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara më këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".

[293] *Minerva Mills Ltd. V. Union of India* (A.I.R. 1980, S.C. 1789) fq. 1798. Për komentet e këtij pozicioni, Cf. Gary Jeffrey Jacobson, "An unconstitutional constitution. A comparative perspective?" *International Journal of Constitutional Law* Vol. 4, No 3 (Jul 2006) fq. 472-476; Lech Garlicki and Zofia A. Gralicka, "Review of Constitutionality of Constitutional Amendments (An Imperfect Response to Imperfections)". Në *Jorurnal of Constitutional Law/Revue De Droit Constitutionnel,* Vo. I, Issue 1 (Istanbul, Turkey: Year 2012) fq. 216-219; Dr. J. N. Pandey, *The Constitutional Law of India*. 47th Edition (CLA: ALLAHABAD, India, 2010) fq. 366-367; 420-421; 770-772.

[294] Paragrafi 259 i aktgjykimit në rastet **K.O. 29/12** dhe **K.O. 48/12.**: "Pasi të zgjidhet, Presidenti mban mandatin deri në pesë vjet. Presidentja aktuale mban mandatin në mënyrë legjitime dhe është, në bazë të zgjedhjes së saj Presidente, garantuese e funksionimit demokratik të institucioneve në shtet. Mandati i Presidentit të Kosovës është përzierje e legjitimitetit të zgjedhjes së tij/saj, kohëzgjatjes së mandatit (pesë vjet) dhe kompetencave që i jepen Presidentit me Kushtetutë, jo vetëm kompetencat e dhëna sipas nenit 84 [Kompetencat e Presidentit] të Kushtetutës".

[295] Paragrafët 260-261 të aktgjykimi në rastet **K.O. 29/12** dhe **K.O. 48/12.**

pushteteve,[296] të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave,[297] barazinë para ligjit,[298] e kështu me radhë. Gjykata, në asnjë rast, nuk ka marrë parasysh kriteret jokushtetuese, njësoj siç është vepruar edhe me rastin e ish-presidentit kosovar, **Fatmir Sejdiu**.[299]

Shikuar në aspektin historik, doktrina për amendamentet jo kushtetuese ka nisur atëherë kur në kushtetutat e para u futën dispozita të qarta dhe konkrete që normonin pengesa të mëdha në rrugën për ndryshimet e ardhshme në tekstin origjinal kushtetuese. Kjo bëhet me qëllim të ruajtjes dhe sigurimit të stabilitet të ri të fituar përmes ushtrimit të vullnetit të sovranit të ri. Në kohën pas rrënimit të monarkive absolute, të shkaktuara nga **Revolucioni Francez** i vitit 1789, e deri me sot, konstitucionalizmi dhe drejtësia kushtetuese, si komponentë e tij, kanë konsistuar në menaxhimin nëpërmjet rrugëve institucionale e formale-kushtetuese të formave të ushtrimit të vullnetit të pakontrolluar të popullit, si sovran i ri në skenën politike evropiane të kohës që zëvendësoi monarkun e dikurshëm si sovran. Dihet mirëfilli se i tërë shekulli XIX ka qenë në shenjë të kontrollit institucional dhe kushtetues të monarkive evropiane dhe synimit për të garantuar stabilitetin e tyre institucional e politik. Teoria për të ashtuquajturat **kushtetuta të ngurta**, i ka shërbyer këtyre qëllimeve e synimeve për stabilitet institucional e politik. Për t'i shërbyer qëllimeve e synimeve të tilla, ajo u formulua sa pari nga **Lord Bryce**.[300] Si praktikë, megjithatë, ajo është më e hershme dhe daton që nga shekulli XVIII. Koncepti për **kushtetutat e ngurta** nuk është vetëm një çështje **ex catedra**; koncepti, po ashtu, nuk është vetëm punë procedure në sensin e ekzistimit të disa pengesave, të cilat pamundësojnë ndryshimin e lehtë dhe të shpejtë të tekstit kushtetues. Disiplina e njohur si amendamentimi kushtetues, sado e një rëndësie tepër të madhe, megjithatë nuk mund ta zbulojë tërë thelbin e ndodhive dhe mënyrën e formimit të sistemit politik fillestar sipas kushtetutës në fuqi, e cila tani cilësohet si e **ngurtë**. Për të kuptuar thelbin e këtyre ndodhive dhe esencën e origjinës së mënyrës së formimit të sistemit politik fillestar në të kaluarën, asnjëherë nuk duhet harruar vlerat substanciale apo materiale, pra jo vlerat procedurale, të cilat garantojnë ngurtësinë e kushtetutës së caktuar. Kjo nënkupton se si procedura ashtu ana materiale apo substanciale e vlerave që sanksionohen me kushtetutë kanë rëndësi të madhe në definimin dhe kuptimin e termit kushtetutë e ngurtë. Se kjo është kështu shihet qartë se në disa shtete ngurtësia e kushtetutës, me të cilën nënkuptohet pamundësi për amendamentim të saj, ka buruar nga jurisprudenca dhe jo nga teksti kushtetues (që ka qenë i heshtur ndaj kësaj çështje). Këtë do ta shohim në vijim me jurisprudencën e disa vendeve. Kur në procedurë dhe në aspektin material ka pajtueshmëri të madhe, gjërat qëndrojnë ndryshe: amendamentimi i kushtetutës pengohet nga të gjitha anët dhe reflekton vullnetin e sinqertë social dhe politik për stabilitet dhe kohezivitet nacional.

Kjo vlen për **Kosovën**, po aq sa vlen edhe për pjesën dërrmuese të demokracive kushtetuese bashkëkohore. Këto vlera substanciale apo materiale që zakonisht sanksionohen përmes dispozitave materiale kushtetuese njihen, siç u pa më herët, me lloj-lloj emrash e shprehjesh. Kjo do të thotë se, megjithatë, këto vlera nuk është e thënë të gjenden shprehimisht nëpër tekstin kushtetues ekzistues. Ka raste kur ato janë krijuar nga praktika e gjatë e ushtrimit të drejtësisë kushtetuese (jurisprudenca kushtetuese).[301] Në hulumtimet shkencore të këtij lëmi, ka rezultuar se vetë supremacia (epërsia) e kushtetutës, kundrejt çdo norme tjetër,

---

296 Paragrafët 267-268 të aktgjykimit në rastet **K.O. 29/12** dhe **K.O. 48/12.**

297 Paragrafët 262-264 të aktgjykimit në rastet **K.O. 29/12** dhe **K.O. 48/12.**

298 Paragrafi 265 i aktgjykimit në rastet **K.O. 29/12** dhe **K.O. 48/12.**

299 Presidenti i Kosovës, **Fatmir Sejdiu**, pat dhënë dorëheqje më 27 shtator 2010. Që atëherë, ai ka folur publikisht për ekzistimin e një marrëveshjeje politike ndërmjet tij dhe faktorëve ndërkombëtarë në mbështetje të "ngrirjes" së pozitës së tij si kryetar i partisë. Ai ka pohuar se, përveç kësaj, kjo marrëveshje e pohuar ka shërbyer si bazë për **travaux preparatoires**, pra si shtyllë për draftimin në formën dhe përmbajtjen aktuale të nenit 84 të Kushtetutës. Cf. Enver Robelli, "Doli prej zarfit, tash nuk del prej zyrës!", gazeta e përditshme **Koha ditore**, 10 korrik 2012, e martë, fq. 10. Në këtë artikull, autori përmend bindjen e fortë të ish-presidentit **Fatmir Sejdiu** për ekzistimin e marrëveshjes së lartcekur "gojore" ndërmjet tij dhe faktorëve kryesorë ndërkombëtarë.

300 James Bryce, *Studies in History and Jurisprudence*. (The Clarendon Press: Oxford, 1901), në veçanti "Essay III: Flexible and Rigid Constitutions", fq. 145-254.

301 Të tilla janë rastet e **Indisë**, të **Gjermanisë**, të **Kanadasë**, etj. Cf. Dr. sc. Jasna Omejec, "Kontrola ustavnosti ustavnih normi (ustavnih amandmanai ustavnih zakona)". **(Control of Constitutionality of Constitutional Norms (Constitutional Amendmends and Constitutional Laws).** *Godisnjak Akademije pravnih znanosti Hrvatske*, Vol. 1 No. 1 (Prosinac 2010) fq. 1-28.

nënkupton ekzistimin e kontrollit gjyqësor, sikundër që **vetë qenia rigjid e një kushtetute fuqizon tej mase kontrollin kushtetues.** Pra, ka një korrelacion pozitiv ndërmjet ekzistimit të një teksti të shkruar kushtetues dhe rigjiditetit të saj të theksuar dhe të një kontrolli të fuqishëm gjyqësor të kushtetutshmërisë.[302] Jo vetëm kaq: në literaturë është vërejtur se rigjiditeti i një kushtetuese shërben edhe si barrierë serioze për amendamentimin e shpeshtë kushtetuese, përkatësisht si faktor dekurajues për amendamentime të shpeshta kushtetuese.[303] Këto tri cilësi, teksti i shkruar, rigjiditeti i në ndryshimin e tij, si dhe kontrolli i fuqishëm kushtetues përbëjnë anët e ndryshme të fenomenit të njëjtë: supremacisë (epërsisë) së kushtetutës si veçori themelore e konstitucionalizmit modern. Historia tregon se e lehtë është të krijosh një komb apo shtet, por gjëja më e vështirë është t'i japësh formë atij kombi apo shteti. Kjo kërkon pajtueshmëri të tri cilësive si më sipër, të tekstit kushtetues, rigjiditetit të tij dhe kontrollit kushtetues që kujdeset për hapjen e rrugëve në mënyrë që ai tekst të ngelet çdoherë një dokument i gjallë që reflekton nevojat reale të secilës kohë.

Në tekstet kushtetuese, apo precedentët e krijuar nga praktika e gjyqeve kushtetuese, esenca e vlerave substanciale apo materiale si më sipër konsiston në atë se vetëm nëpërmjet analizës dhe studimit të tyre mund të kuptohet përfundimisht historiku dhe zhvillimi i sistemit politik fillestar (origjiner), i ndërtuar sipas procedurave të kushtetutës rigjide. Këto vlera substanciale apo materiale të cilat strehohen në dispozitat kushtetuese materiale apo në precedent e krijuara nga gjyqësia kushtetuese, **ngërthejnë disa vlera dhe parime të pandryshueshme kushtetuese** dhe paraqesin një lloj **kodi gjenetik** të secilës kushtetutë.[304] Në këtë drejtim, **Kosova**, nuk bën përjashtim: kapitulli II i Kushtetutës për të drejtat dhe liritë e njeriut është **kodi gjenetik** i saj, vija e kuqe, ndryshimi eventual i të cilit do ta shkatërronte formën dhe përmbajtjen e sistemit aktual kushtetues dhe politik kosovar, të formësuar këtyre viteve mbi bazën e tekstit (rigjid)

---

[302] Arend Lijphart, *Patterns of Democracy. Government forms and Performance in Thirty-Six Countries* (Yale University Press: New Haven and London, 1999) fq. 217-230; Finsik Korenica, Dren Doli, "Constitutional Rigidity in Kosovo: Significance, Outcomes, and Rationale". *International Law Review Online Companion* Vol. 2 No. 6 (January 2011) fq. 1-28 (ku autorët në kontekstin kosovar diskutojnë këtë korelacion dhe kjoinstatojnë se vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë rëndësi të madhe si pasojë e rigjiditetit kushtetues në Kosovë).

[303] Në një studim kuantitativ të thellë lidhur me shpeshtësinë e amendamentimeve kushtetuese janë zbuluar tetë supozime që kanë të bëjnë me fenomenin e shpeshtësisë së ndryshimeve kushtetuese. Ky hulumtim është kryer me pikë referimi ish-vendet komuniste të Evropës Qendrore dhe Lindore. Supozimet në fjalë janë:

- *i pari* supozim ka të bëjë me origjinën e tekstit kushtetues: kushtetutat e vjetra amendamentohen më shpesh sepse nuk iu përshtaten rrethanave konkrete të tanishme (kjo hipotezë është testuar në rastin e **Hungarisë**, **Polonisë** dhe **Latvisë**, të cilat kanë ruajtur kushtetuatat e kohës ish-komuniste dhe kanë synuar reformimin e tyre; kjo do të thotë se me termin "origjinë" këtu nënkuptohen rrethanat e nxjerrjes së kushtetutës së parë dhe sistemi socio-politik dhe ekonomik që ka qenë objekt i normimit kushtetues origjinal);
- *i dyti* supozim ka të bëjë me legjitimitetin e kushtetutëbërjes së parë: në vendet ku kushtetuta aprovohet nga një kuvend kushtetues apo me referendum, shpeshtësia e ndryshimit të saj do të jetë më e rrallë se në rastet kur ajo është miratuar nga një kuvend i zakonshëm (rasti i Kosovës);
- *i treti* supozim ka të bëjë me vonesat në miratimin e kushtetutës së parë: sa më shumë që vonohet nxjerrja e kushtetutës pas ndryshimeve revolutive, aq më pak do të ketë nevojë për amendamentime të mëpastajmë sepse teksti kushtetues reflekton realitetin e regjistruar përgjatë një kohë të gjatë të vonimit. Thënë ndryshe, kushtetutat nuk duhen nxjerrë në shpejtësi, por duhet të jenë rezultat e një studimi të gjatë të përvojës jetësore të një shoqërie;
- *i katërti* supozim ka të bëj me rigjiditetin. sa më rigjid ndryshimi i kushtetutës, aq më e vogël shpeshtësia e amendamentimeve (rasti i Kosovës);
- *i pesti* supozim ka të bëj me gjatësinë e tekstit kushtetues: sa më i gjatë teksti kushtetues, aq me e rrallë është shpeshtësia e ndryshimit të kushtetues; dhe
- *i gjashti* supozim ka të bëj me natyrën e regjimit: mesatarja e amendamentimeve kushtetuese në vendet demokratike dhe ato jodemokratike është e njëjtë;
- *i shtati* supzoim ka të bëj me fragmentimin politik. sa më i fragmentuar organi përfaqësues, parlamenti, aq më pak amendamentime të kushtetutës do të ketë; dhe
- *i teti* supozim ka të bëj me kohën: sa më gjatë të jetë në fuqi një kushtetutë, aq më larg realitetit të përditshëm do të jetë edhe nevoja për amendamentim të saj do të rritet. Cf. Anna Fruhstorfer and Michael Hein, "From Post-socialist Transition to the Reform of Political Systems? Comparing Constitutional Politics in Central and Eastern Europe". Në në Anna Fruhstorfer and Michael Hein (eds.), Constitutional Politics in Central and Eastern Europe. From Post-Socialist Transition to the Reform of Political Systems (Springer: Wiesbaden, 2016) fq. 547-576 në fq. 554-557.

[304] Kjo shprehje për herë të parë është përdorur nga Carlo Fusaro dhe Dawn Oliver. "Toëards a Theory of Constitutional Change". Në Dawn Oliver and Carlo Fusaro (eds.), *How Constitutions Change. A Comparative Study* fq. 405-434 në fq. 428.

origjinal (fillestar) kushtetues, të datës 15 qershor 2008.[305] Kjo do të thotë se amendamentimi i Kushtetutës së vitit 2008 has në vështirësi, të cilat nuk lidhen vetëm me procedurën e vështirë për amendamentimin e saj,[306] por, mbi të gjitha dhe kryesisht, me vështirësitë që i referohen parimeve dhe vlerave substanciale apo materiale kushtetuese të kapitullit II të Kushtetutës dhe të dispozitave të tjera materiale.[307]

Ideja e kontrollit kushtetues të amendamenteve kushtetuese tingëllon paradoksale në sensin që, në këto raste, bëhet kontrolli kushtetues i një norme të propozuar kushtetuese, duke e krahasuar me një normë tjetër kushtetuese, e cila gjendet në tekstin fillestar (origjinal) kushtetues. Kjo, vetvetiu, hap dilema kuptimore, sepse vetë ideja e drejtësisë kushtetuese, në kuptim të ngushtë të fjalës, e konceptuar nga **Hans Kelsen.** konsiston në kontrollin kushtetues të normës ligjore, si normë më e ulët se norma kushtetuese, për të parë nëse norma e tillë ligjore është në pajtim (harmoni) me normën kushtetuese, si normë më e lartë për nga fuqia juridike në hierarkinë e përgjithshme të normave. Megjithatë, ky lloj kontrolli kushtetues jo vetëm që ekziston por, në disa vende, si p.sh., në **SHBA**, është më i vjetër sesa vetë kontrolli kushtetues i ligjeve.[308]

Arsyeja kryesore dhe e vetme për ekzistimin e këtij lloji të kontrollit kushtetues qëndron në faktin se, në mjaft raste, kushtetutat përmbajnë parime e dispozita që konsiderohen si të paamendamentueshme. Kjo do

---

[305] **Kosova** ka shpallur **Deklaratën e Pavarësisë** më 17 shkurt 2008. Më pas, **Kuvendi i Kosovës**, bazuar në këtë deklaratë, më 9 prill 2008, ka miratuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi më 15 qershor të të njëjtit vit. **Këto akte janë ndërmarrë nga përfaqësuesit e popullit të Kosovës, jo nga strukturat e pushtetit të krijuara në Kosovë pas qershorit të vitit 1999, mbi bazën e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, të datës 10 qershor 1999**.
Nga ana e **GJND**, kjo shpallje është vlerësuar si akt i ushtrimit të pushtetit konstitutiv **(pouvoir constiuant**), jo atij të krijuar (**pouvoir constitue**), i cili ka funksionuar në Kosovë mbi bazën e **Rezolutës 1244** të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, të datës 10 qershor 1999. Cf. Paragrafët 102-109, 118 dhe 121 të **Mendimit të GJND-së për Kosovën**, datë 22 korrik 2008. *International Court of Justice* (ICJ). *Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in respect of Kosovo*. **Advisory Opinion**. 22 July 2010; Për komentet e këtij vendimi, në literaturë, Cf. James Summers (ed.), *Kosovo: A Precedent? The Declaration of Independence, the Advisory Opinion and Implications for Statehood, Self-Determination and Minority Rights* (Martinus Nijhoff Publishers: The Hague, 2011); Michael Bothe, "Kosovo – So What? The Holding of the International Court of Justice Is Not the Last Word on Kosovo's Independence". *German Law Journal,* Vol. 11, No. (2010); Robert Howse & Ruti Teitel, "Delphic Dictum: How Has the ICJ Contributed to the Global Rule of Law by its Ruling on Kosovo?" *German Law Journal,* Vol. 11, No. 08 (2010); Björn Arp, "The ICJ Advisory Opinion on the Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in Respect of Kosovo and the International Protection of Minorities". *German Law Journal,* Vol. 11, No. 08 (2010); Robert Muharremi, "A Note on the ICJ Advisory Opinion on Kosovo". *German Law Journal,* Vol. 11, No. 08 (2010); Thomas Burri, "The Kosovo Opinion and Secession: The Sounds of Silence and Missing Links". *German Law Journal,* Vol. 11, No. 08 (2010); James E. Moliterno F, "What the ICJ's Decision Means for Kosovars". *German Law Journal,* Vol. 11, No. 08 (2010); Elena Cirkovic, "An Analysis of the ICJ Advisory Opinion on Kosovo's Unilateral Declaration of Independence". *German Law Journal,* Vol. 11, No. 08 (2010); Hanna Jamar & Mary Katherine Vigness, "Applying Kosovo: Looking to Russia, China, Spain and Beyond After the International Court of Justice Opinion on Unilateral Declarations of Independence". *German Law Journal*, Vol. 11, No. 08 (2010); Toma Galli, "Kratka analiza Savjetodavnog misljenja Medjunarodnog suda o proglasenju neovisnosti Kosova s medunarodnim pravom". *Zbornik Pravnog Fakulteta u Zagrebu,* Vol. 61 No. 6 (Prosinac 2011).

[306] Neni 144, paragrafi 2 ["Amendamentimi"] i Kushtetutës: "Çdo ndryshim do të kërkojë miratimin e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit që mbajnë **vende të garantuara** për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës".

[307] Në Aktgjykimin për **rastin Jahjaga**, Gjykata ka bërë me dije shumë qartë se kapitulli II i Kushtetutës nuk mund të shikohet në mënyrë të izoluar nga kapitulli III në vijim, i cili mbron të drejtat dhe liritë e bashkësive jo shumicë në Kosovë. Për më tepër, Gjykata ka vënë në dukje se nuk janë vetëm këta dy kapituj që merren parasysh nga ajo me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese, por edhe parimet e vlerat e tjera të sanksionuara me Kushtetutë. Cf. Paragrafët 61-68 të Aktgjykimit në rastet **K.O. 29/12** dhe **K.O. 48/12.**
Kjo qasje e Gjykatës është në vijë të njëjtë me teorinë dhe me praktikën e **Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë**, e cila e sheh **Ligjin Themelor të RF të Gjermanisë** si një tërësi organike, një unitet strukturor të vlerave dhe të parimeve kushtetuese që kanë vlerë normative, e njihur në doktrinën gjermane si **praktische Konkordanz.** Në këto vlera e parime kushtetuese të kuptuara kësisoj qëndron thellë e rrënjosur jurisprudenca gjermane mbi amendamentet jokushtetuese, përkatësisht mbi ndalimin e amendamenteve kushtetuese që cenojnë këtë unitet strukturor të vlerave e parimeev kushtetuese me fuqi normative**.** Cf. më shumë për këtë në Donald P. Kommers, "German Constitutionalism: A Prolegomenon", fq. 837-873 në fq. 845-851; Donald P. Kommers, *The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany*, fq. 31, 45-46, 48, 476 (faqja e fundit flet për **amendamentet e antikushtetuese** në kontekstin e lirive fetare).

[308] Vendimi i parë i Gjykatës Supreme përkitazi me kushtetutshmërinë e amendamenteve kushtetuese është marrë më 1798, në rastin **Hollingsëorth v. Virginia**, pesë vjet para rastit **Marbury v. Madison** (1803), me të cilin u themelua praktika e kontrollit kushtetues të ligjeve. Cituar në Kemal Gozler, *Judicial Review of Constitutional Amendmnets. A Comparative Study*, fq. 29.

të thotë se, parimet e dispozitat e tilla, në asnjë rast nuk mund të jenë objekt amendamentimi. Këto parime e dispozita, të cilat nuk mund të jenë objekt amendamentimi në asnjë rast apo rrethanë, u cilësuan me emra të ndryshëm nga teoria kushtetuese. Kjo u tha më sipër në këtë seksion. Këtu mjafton të thuhet se, termi i përdorur për herë të parë, me qëllim të tregimit të parimeve dhe të dispozitave kushtetuese që nuk mund të amendamentohen, ka qenë **dispozitat e rrënjosura** (**entrenched provisions**) dhe është futur në përdorim nga **Karl Shmit** para **Luftës së Dytë Botërore**.[309] Në **Evropë**, pas **Luftës së Dytë Botërore**, koncepti për **dispozitat e rrënjosura** (**entrenched provisions**) u rikrijua nga doktrina gjermane:[310] Siç u theksua më herët, në një mënyrë krejt paradoksale, ka qenë **Karl Shmit** prapa idesë së tekstit nga dispozita 79.3 e **Ligjit Themelor të RF të Gjermanisë**, nen ky në të cilin u mbështet teoria dhe praktika gjermane mbi **parimet dhe dispozitat e paamendamentueshme kushtetuese.** Nganjëherë kjo cilësohet si teoria dhe praktika për **amendamentet kushtetuese jokushtetuese** (**unconstitutional constitutional amandements**).[311] Ky term mund të tingëllojë çuditshëm dhe paradoksal, por kjo nuk është kështu. Kështu ka konstatuar me shumë të drejtë **Gjykata Kushtetuese e Bavarisë**, në një vendim të saj të datës 24 prill 1950, i cili konsiderohet si vendimi i parë lidhur me amendamentet kushtetuese jo kushtetuese, shprehjet e të cilit më vonë u përdorën konceptualisht nga **Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë** në **Southewest Cas**e.

"Edhe pse pjesë e vetë Kushtetutës, nuk është konceptualisht e pamundur që të konsiderohet si e pavlefshme një dispozitë kushtetuese. Disa parime kushtetuese janë aq bazike sa që i manifestojnë parimet juridike që i paraprijnë nxjerrjes së Kushtetutës dhe e obligojnë edhe vetë kushtetutëbërësin. Dispozitat tjera kushtetuese që bien ndesh me këto parime juridike që ekzistojnë që nga koha para nxjerrjes së Kushtetutës konsiderohen të pavlefshme".[312]

Kjo teori, dhe praktika e bazuar mbi të, duhet të dallohen nga **pengesat procedurale kushtetuese**, të cilat vështirësojnë dukshëm, nganjëherë edhe e bëjnë të pamundshëm, amendamentimin e kushtetutës. Në këso raste, pa pasur një konsensus substancial brenda shoqërisë, nuk mund të ndodhë amendamentimi kushtetues. Këto pengesa, për herë të parë, janë sanksionuar në nenin V të **Kushtetutës Amerikane** të vitit 1787 dhe, më pastaj, janë bartur nëpër kushtetutat e vendeve të tjera, por janë rimodeluar në mënyra të ndryshme. Këto dispozita procedurale paraqesin kuptimin e **kushtetutës rigjide**, e cila u diskutua më herët. Në rastin e teorisë dhe të praktikës për parimet dhe për dispozitat e paamendamentueshme, megjithatë, bëhet fjalë për parime dhe për dispozita që gjenden në pjesët materiale të kushtetutës. Si të tilla, ato vetvetiu nuk mund të jenë objekt amendamentimi. Dispozitat procedurale, që paraqesin kuptimin e **kushtetutës rigjide**, përkundrazi, mund të ndryshohen nëse ndjekin procedurën e paracaktuar kushtetuese.

---

309 Ai përdori këtë term, siç u tha më herët në këtë shkrim, në një analizë të tij për kapitullin II të **Kushtetutës së Vajmarit**, ku sanksionoheshin të drejtat dhe liritë e gjermanëve. Këto **dispozita të rrënjosura**, sipas tij, paraqisnin kushtetutën e dytë të **Gjermanisë**, krahas **Kushtetutës së Vajmarit**. Pse? Sepse, mendonte ai, ky kapitull kufizonte ushtrimin e pushtetit shtetëror të presidentit të **Rajhut** dhe të qeverisë së tij, meqenëse krijonte detyrime shtesë dhe të veçanta për këto organe, duke i frenuar në favor të realizimit të të drejtave të gjermanëve. Cf. Karl Smit, "Legalnost i Legitimnost", fq. 323-336. Për më shumë komente nga autorët tjerë, cf. Ulrich K. Preuss, "The Implications of 'Eternity Clauses': The German Experience". Në *Israel Law Review*Vol. 44 No. 3 (2012).

310 Rasti i parë në praktikë në nivel federal ka ndodhur si pjesë e një **obiter dictum** në rastin **SouthWest Case** (1951) Në këtë rast, **Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë** ka theksuar se ekzistojnë disa parime e vendime të cilave i nënshtrohen dispozitat e tjera kushtetuese dhe të cilat nuk mund dhe nuk guxojnë të cenohen në asnjë rast. Cf. Kemal Gozler, *Judicial Review of Constitutional Amendmnets. A Comparative Study,* fq. 55-56; 84-86; Donals P. Kommers, "German Constitutionalism.: A Prolegomenon", fq. 858-859, fusnota nr. 60; Richard Davis & D Jeffrey Burnham, "The Role of the Federal Judiciary in the Development of Federalism in West Germany and the United States". *Boston College International and Comparative Law Review* Vol. 12 Issue 1 (1989) fq. 63-88 në fq. 71-72.
Shih më gjerësisht vetëm pë rastin në fjalë në Gerhard Leibholz, " The Federal Constitutional Court in Germany and the 'South-West Case' " *The American Political Science Review* Vol. 46, No. 3 (September, 1952), fq. 723-731.

311 **Kushtetuta e SHBA**-së, në nenin V, flet për ndalimin e çfarëdo amendamenti që cenon të drejtën e votës së barabartë të shteteve anëtare, kurse **Kushtetuta e Norvegjisë**, e vitit 1814, në nenin 112 të saj, flet për ndalimin e çfarëdo amendamentimi që bie ndesh me parimet dhe me shpirtin e tekstit origjinal kushtetues. Cf. më shumë për këtë në Kemal Gozler, *Judicial Review of Constitutional Amendments. A comparative Perspective*, fq. 10-12; 28-34; 78-80; Lechh Garlicki and Zofia A. Garlicka, "Review of Constitutionality of Constitutional Amendments (An Imperfect Response to Imperfections). *Journal of Constitutional Law/Anayasa Hukuku Dergisi* Vol. 1, Issue 1 (Year 2012) fq. 185-223 në fq. 205 fusnota nr. 46.

312 Donald P. Kommers, *The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany,* fq. 542 (fusnota nr. 90).

Ky dallim, siç shihet, është mjaft i madh, sepse, derisa të parat nuk mund të ndryshohen fare, në rastin e dispozitave procedurale kushtetuese, ndryshimi nuk përjashtohet nëse ndiqet një procedurë e paracaktuar kushtetuese.

Në vijim për sa më sipër, këto parime e dispozita të paamendamentueshme janë vetë identiteti kushtetues i një vendi, vetë **ADN**-ja e tij, pa të cilat vetë kushtetuta nuk ka asnjë kuptim. Parimet dhe dispozitat, të cilat nuk mund të ndryshohen asnjëherë dhe në asnjë rrethanë, zakonisht i referohen formës së qeverisjes, raportit ndërmjet qendrës dhe periferisë shtetërore, laicitetit të shtetit, demokracisë kushtetuese, sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut, etj. I tillë është rasti, ta zëmë, i **Gjermanisë**, i **Francës,** i **Turqisë**, i **Norvegjinë**, i **Portugalisë**, i **Rumanisë**, i **Ukrainës**, i **Azerbajxhanit**, i **Afrikës së Jugut**, dhe i mjaft shteteve të tjera. Këtu e kemi fjalën për vendet që kultivojnë demokraci kushtetuese të modeluar sipas konstitucionalizmit perëndimor, sepse ka vende të tjera, ta zëmë **Maroku**, por edhe vendet tjera islamike, në të cilin, si dispozita të paamendamentushme, janë ato që kanë të bëjnë me ruajtjen e rolit primar të islamit në shoqëritë e këtyre vendeve.[313] Këtë e kemi treguar në kapitujt pararendës kur kemi folur për vendet islamike.

Vetë ekzistimi i këtyre parimeve e i dispozitave të paamendamentueshme kushtetuese, gëzon mbrojtje gjyqësore në sensin që çdo amendament kushtetues, i cili bie ndesh me to, shpallet antikushtetues nga gjykata respektive. Kjo, megjithatë, nuk do të thotë se kontrolli kushtetues i amendamenteve ekziston vetëm në ato vende ku kushtetutat përmbajnë parime dhe dispozita të paamendamentueshme dhe anasjelltas. Ka raste kur teksti origjinal ekzistues kushtetues përmban parime dhe dispozita kushtetuese që nuk mund të amendamentohen, por që në praktikë kurrë nuk ka ndodhur kontrolli i amendamenteve kushtetuese. I tillë është rasti, ta zëmë, me **Kushtetutën e Norvegjisë**, të vitit 1814. Njëjtë me këtë, ka raste kur fare nuk ekzistojnë parime dhe dispozita kushtetuese, të cilat nuk mund të amendamentohen, por që, në praktikë, gjykatat respektive kanë zhvilluar një praktikë gjyqësore për lakmi dhe tepër të pasur. I tillë është rasti, ta zëmë, i **Indisë**.

Së fundi, rasti i kontrollit kushtetues të amendamenteve është kontroll abstrakt i normës juridiko-kushtetuese, pra nuk i referohet zbatimit të saj në një rast konkret, por ndaj të gjitha rasteve të kohës që vjen. Në pjesën dërrmuese të shteteve, kontrolli abstrakt i normës juridiko-kushtetuese kryhet vetëm **a posteriori**, pra pasi të ketë hyrë në fuqi norma juridiko-kushtetuese e përmbajtur në amendament. Përjashtimet janë të rralla, siç u theksua më herët, kur kontrolli kushtetues i amendamenteve kryhet para se ato të hyjnë në fuqi. Në këtë përjashtim, në Evropë, bën pjesë edhe **Kosova**, kurse jashtë Evropës**: Kili**, **Afrika e Jugut**, **Azerbajxhani** etj.

Në vijim të zbatimit të dispozitës kushtetuese të neneve 113.9 dhe 144.1 të Kushtetutës së Kosovës, të cilat parashohin si të detyrueshëm dërgimin për kontroll kushtetues të çdo amendamenti kushtetues, ka lindur edhe çështja në **rastin Jahjaga**. Kontestimi i legjitimitetit të postit të saj nuk ishte mbi bazën e argumenteve juridiko-kushtetuese, por tërësisht politike që bazoheshin në marrëveshjen politike të datës 6 prill 2011 dhe në bindjen se ish-Presidentja Jahjaga **nuk përfaqësonte vullnetin politik të popullit të Kosovës**, kurse Gjykata, sipas kontestuesve, kishte gabuar kur kishte konstatuar se **populli i Kosovës pret që presidentja të jetë përfaqësuese e tyre për pesë vjetët e ardhshëm.**

Ky seksion trajton vetëm anën jopolitike të çështjes në **rastin Jahjaga**, pra atë që ka të bëjë me sqarimin komparativ të kontrollit abstrakt dhe preventiv (paraprak) të amendamenteve, të cilin Gjykata e kryen në bazë të neneve 113. 9 dhe 114.3 të Kushtetutës së vitit 2008. Politikës ditore dhe aktorëve të saj, i lihet liri e plotë e gjykimit në kontestimet reciproke politike **ad hominem**. Këto kontestime, në asnjë mënyrë, nuk mund ta zbehin esencën e teorisë dhe të praktikës për **amendamentet kushtetuese jokushtetuese** dhe për vënien e saj në jetë në rastin konkret të presidentes **Jahjaga**.

---

[313] Jo vetëm **Maroku**, por edhe shumë vende islamike, kanë të njëjtin modelim të dispozitave kushtetuese të paamendamentueshme dhe i referohen kryesisht rolit primar të fesë islame në shoqëritë e tyre. Cf. për këtë më shumë në Amina El Messaoudi,"Il Modelo di Giustizia Costituzionale in Marocco". Në Luca Mezzeti, *Sistemi e Modeli di Giustizia Costituzionale*. Tomo II (CEDAM: Padova, 2011) fq. 367-382.

Në rastin e **Kosovës**, kjo teori dhe praktikë, mbështet vetëm te një fjali, e cila thotë se çdo amendament kushtetues duhet të shkojë në Gjykatë për kontroll gjyqësor, për të parë nëse amendamenti i propozuar zvogëlon të drejtat nga kapitulli II i Kushtetutës. Kjo do të thotë se, në praktikë, kapitulli II i Kushtetutës është **ADN**-ja e Kushtetutës së vitit 2008, vetë identiteti i Kosovës si shtet sovran e i pavarur. Çdo kontroll gjyqësor i amendamenteve si më sipër, bëhet **in abstracto**, duke i marrë parasysh vetëm kriteret e gjykimit profesional abstrakt, të cilat vlejnë çdo herë, për këdo dhe në çdo rast apo rrethanë në të ardhmen. Kjo do të thotë se Gjykata fare nuk ka pasur mundësi që të marrë parasysh se çfarë ka qenë forma dhe përmbajtja e marrëveshjes politike, e lidhur më 6 prill 2011 në mes të liderëve politikë të Kosovës së asaj kohe, e as kush dhe si është bërë president i Kosovës në vijim të zbatimit të marrëveshjes së tillë. Këto aspekte kanë qenë dhe mund të jenë objekt i diskursit publik e politik kosovare, jo i **Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.**

11.3.10. Juridiksioni shtesë i përcaktuar me ligj

Sipas nenit 113.10 të Kushtetutës, Gjykata mund të ketë juridiksion shtesë, jashtë juridiksionit nga neni 113. Këtu nuk bëhet fjalë për juridiksionin shtesë të përcaktuar me Kushtetutën e vitit 2008, siç është rasti me juridiksionin kushtetues që ka të bëjë me realizimin e vetëqeverisjes lokale dhe barazinë e komuniteteve të Kosovës nga neni Në këtë kuptim është rasti i njohur si rasti i **Logos së Prizrenit**.[314] Në këtë rast, juridiksioni i Gjykatës është bazuar në nenin 62.4 të Kushtetutës.[315]

Në dispozitën e nenit 113.10 bëhet fjalë për juridiksionin kushtetues që përcaktohet me një ligj (qoftë ai ligj i zakonshëm apo ndonjë ligj tjetër që miratohet me procedurë të veçantë dhe për çështje të veçanta), pra jo për një juridiksion që përcaktohet me Kushtetutë në dispozitat tjera të saj jashtë atyre nga neni 113.

Në kapitujt paraprakë kemi folur se ky lloj juridiksioni, i përcaktuar me ligj, nuk është i panjohur në jurisprudencën komparative të gjyqësisë kushtetuese. Si i tillë, megjithatë, nuk i shkon natyrës së gjyqësisë kushtetuese të modelit **evropian/kelsenian**, në të cilin një gjykatë e ndarë kushtetuese me juridiksion të qartë dhe të përcaktuar me kushtetutë ushtron kontrollin e kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin e kushtetutës me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së saj kundrejt çdo akti tjetër juridik. Në literaturë me plotë të drejtë është vërejtur se caktimi i juridiksionit shtesë me ligj përbën një ulje të standardeve lidhur me parametrat përcaktues të juridiksionit kushtetues: juridiksioni dhe palët e autorizuara, imuniteti i gjyqtarëve kushtetues, garantimi i pavarësisë së tyre, përfundimi i mandatit të gjyqtarit kushtetues, si dhe çështje të tjera si këto hyjnë në prerogativa të pastra kushtetuese, që nuk duhet të përcaktohen me ligj por vetëm me tekstin e kushtetues.[316]

Në disa vende, siç kemi vërejtur, juridiksioni shtesë mund të caktohet, dhe zakonisht caktohet, me ligjin organik që normon organizimin, procedurën dhe punën e gjithëmbarshme të gjykatës kushtetuese. Në **Kosovë** nuk lejohet caktimi i juridiksionit shtesë përmes ligjit që normon organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese - **Ligji nr. 03/L-121**. Kjo mund të bëhet vetëm përmes ligjit të veçantë. Në disa vende, në mënyrë të rreptë dhe të qartë ndalohet caktimi apo pezullimi i juridiksionit të gjykatës kushtetuese përveç rasteve kur kjo bëhet me norma kushtetuese.[317] Zgjidhja e fundit mund të quhet si më e sakta sa i përket fizionomisë së pastër të gjyqësisë kushtetuese **evropiane/kesleniane**, ku një organ

---

314 *Rasti KO 01/09. Aktgjykim. Parashtrues: Qemajl Kurtishi dhe Kuvendi Komunal i Prizrenit*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtine, datë: 18 mars 2010 Ref. Nr. AGJ 07/10.

315 Neni 62 [Përfaqësimi në Organet e Pushtetit Lokal] i Kushtetutës:
"[...] 4. Në rast se kuvendi i komunës vendos që të mos rishqyrtojë aktin a vendimin e vet, ose nëse zëvendëskryetari vlerëson se, edhe pas rishqyrtimit rezultati përbën shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, ai/ajo mund të parashtrojë çështjen drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese, e cila mund të vendosë nëse do të pranojë ta shqyrtojë rastin përkatës".

316 Dren Doli & Fisnik Korenica, " Kosovar Constitutional Court's Jurisdiction: Searching for Strengths and Weaknesses ", fq. 808-809.

317 **Kapitulli i tetë ["Gjykata Kushteteuse"], neni** 149 (2) i Kushtetutës së Bullgarisë së vitit 1991, që flet për kompetencat, thotë: "Gjykata Kushtetuese. […] 2. Me ligj nuk mund të shtohet apo suspendohet asnjë prej kompetencave të Gjykatës Kushtetuese." Në internet: http://www.parliament.bg/en/const (shikuar në janar 2018); Për zgjidhjet në vendet tjera, ku përcaktohet juridiksioni shtesë me ligj, kemi folur në kapitujt tjerë që kanë të bëjnë me zhvillimin e juridiksionit kushtetues nëpër vendet e ndryshme të botës.

i ndarë nga gjyqësori, ka mandat të qartë dhe të pastër të caktuar me norma kushtetuese, për të bërë interpretim dhe kontroll kushtetues të akteve juridike, veprimeve apo mosveprimeve të autoriteteve publike. Kjo qasje i siguron gardianit të kushtetutës një pozitë më të favorshme dhe më të sigurt sepse nuk lejon ndryshimin me ligj të zakonshëm apo me ligj tjetër të veçantë të juridiksionit të tij themelor kushtetues. Ka pasur përjashtime nga kjo rregull, megjithatë. I tillë është, ta zëmë, rasti me **Gjermaninë**, kur juridiksioni jo vetëm që është caktuar me ligj, por edhe ka qenë definues i fizionomisë së gjyqësisë kushtetuese në këtë vend. E kemi fjalën për juridiksionin sipas aneksës kushtetuese, e cila në **Gjermani** është futur përmes ligjit të veçantë dhe nuk ka qenë e përcaktuar në **Ligjin Themelor** (1949).[318] Sikundër dihet, një ndër sukseset më të mëdha të gjyqësisë kushtetuese gjermane ka qenë pikërisht në sferën e ankesës kushtetuese, e cila më pastaj ka shërbyer si një shembull në vendet tjera, në fillim në **Spanjë** e më pastaj në shumicën e vendeve të **Amerikës Latine** dhe të vendeve të **Evropës** ish-komuniste.

Ky paragraf i Kushtetutës, prandaj, i jep mundësinë Kuvendit që të përcaktojë juridiksion shtesë për Gjykatën. Kjo, megjithatë, duhet lexuar edhe si ndalesë që Kuvendi të mund të zvogëlojë apo të heqë juridiksionin e përcaktuar me nenin 113.[319] Duhet thënë që, në ushtrimin e të drejtës së tij për të caktuar juridiksion shtesë me anë të ligjit, Kuvendi i nënshtrohet juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese për kontroll të kushtetutshmërisë së ligjeve. Kjo nënkupton se Gjykata është gjithashtu e autorizuar që të kontrollojë nëse ligji për juridiksion shtesë, i iniciuar për kontroll kushtetues përmes një pale të autorizuar, është në përputhje me parimet dhe normat kushtetuese, apo, në pajtim me germën dhe frymën e saj, pra nëse eventualisht cenon ndonjë standard të funksionit të saj kushtetues.

Në **Kosovë**, si u theksua më herët, ekzistojnë dy raste kur me ligje të veçanta është caktuar juridiksioni shtesë i Gjykatës në kuptim të nenit 113.10 të Kushtetutës.[320] Fjalën e kemi për juridiksionin shtesë që parashihet për Gjykatën në dy raste: neni 106.1 ["Rezultatet Zgjedhore"] i **Ligjit Nr. 03/L-073** për Zgjedhjet e Përgjithshme, datë 5 qershor 2008,[321] dhe neni 64.3 ["Shkarkimi"] i **Ligjit Nr. 03/L-04** për Vetëqeverisjen Lokale, datë 20 shkurt 2008.[322] Këto dy nene kërkojnë një sqarim për lexuesin për të parë se për çfarë bëhet fjalë këtu.

Në rastin e parë, deri në amendamentimet e vitit 2010, përcaktohej se certifikimi i zgjedhjeve nuk mund të bëhej pa u kryer procedurat e ankimit në **Gjykatën Kushtetuese**. Pra fjala ka qenë për procedurat që individët apo subjektet tjera juridike mund t'i ngrehnin me kërkesa që pohojnë cenim të të drejtave të tyre zgjedhore si dhe të drejtave të tjera lidhur me zgjedhjet nacionale. Kjo, siç u tha, tani ka ndryshuar: më certifikimi i zgjedhjeve nacionale nuk duhet të presë derisa të kryhen procedurat e nisura në Gjykatën Kushtetuese sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, por mund të certifikohen menjëherë pasi Gjykata Supreme e Kosovës të japë verdiktin e saj të fundit rreth ligjshmërisë së zgjedhjeve. Kjo do të thotë se çdo shkelje kushtetuese eventuale mund të presë në Gjykatën Kushtetuese, sipas procedurave të rregullta që vlejnë për ankesën kushtetuese, ku nuk ka një afat ligjor brenda të cilit duhet të vendoset një rast. Në rast se me vonë me vendim konstatohet se ka pasur shkelje kushtetuese, atëherë efektet e tij do të jenë për të ardhmen, **ex nunc**, duke konsideruar si legjitim çdo veprim të ndërmarr nga deputetët e zgjedhur, por në ndërkohë i cilësuar si jo kushtetues me vendim të **Gjykatës Kushtetuese.**

---

318 Wilhelm Karl Geck, "Judicial Review of Statutes A Comparative Survey of Present Institutions and Practices", fq. 250-304 në fq. 254

319 Si shembull krahasues, **Gjykata Supreme Federale e Brazilit** në vendimin ADI 2.797 theksoi se një ligj statusor nuk mund të zgjerojë kompetencat në fushën e juridiksionit kushtetues. Çdo ligj që i interpreton dispozitat kushtetuese uzurpon kompetencat e Gjykatës Supreme Federale. (Vendim i Gjykatës Supreme Federale të Brazilit ADI 2.797 i datës 15.09.2005).

320 Cf. fusnota nr. 24, **supra**, në këtë kapitull si dhe teksti që e shoqëron.

321 Ky juridiksion është shuar me amendamentimet e vitit 2010 dhe nuk ekziston më. Tani certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve bëhet pasi të jenë kryer të gjitha procedurat pranë gjyqësorit të rregullt, përkatësisht pranë **Gjykatës Supreme të Kosovës**. Cf. fusnota nr. 24, **supra**, në këtë kapitull si dhe teksti që e shoqëron.

322 Cf. fusnota nr. 24, **supra**, në këtë kapitull si dhe teksti që e shoqëron.

Në rastin e dytë fjala është për një procedurë pak më specifike, ku vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka natyrën e një vendimi këshilldhënës. Ky juridiksion i ngjason shumë juridiksionit të **Gjykatës Kushtetuese të Rumanisë**, që u diskutua më sipër. Arsyeja pse i lihet Gjykatës Kushtetuese për të vendosur, është fare e thjeshtë: ligjvënësi niset nga parimi se mandati i kryetarit të komunës është mandat që merret në zgjedhje lokale të drejtpërdrejta ashtu që legjitimiteti i tij mund dhe duhet të kontestohet vetëm në rastet rënda të shkeljeve kushtetuese e ligjore, që nuk vlerësohen nga politika por nga një organ i tretë, neutral, siç është Gjykata Kushtetuese. Në çështjet e pushtetit lokal, siç kemi thënë në rastin e **Turqisë**, **Komisioni i Venecias** e ka bërë të qartë se mandatet e marra me votën e qytetarit nuk mund të ndërpriten në mënyrë arbitrare dhe politike, por vetëm në procedura të suspendimit, vlerësimit të fajësisë (penale dhe kushtetuese) të bartësit të funksionit ashtu që vetëm më pas të mund të merren masat e duhura përkatëse. Se kjo është kështu, qartë shihet nga përcaktimet ligjore kosovare në lëmin e vetëqeverisjes lokale, të cilat i diskutojmë në vijim.

Sipas **Ligjit Nr. 03/L-04, si** më sipër, ekzistojnë tri faza që duhen pasur parasysh dhe që vërtetojnë atë që thamë më lart. *Faza e parë* është kur kryetari i komunës ka cenuar Kushtetutën dhe ligjet në fuqi. Në këtë rast, ministria përgjegjëse për pushtet lokal i rekomandon Qeverisë në përbërje të plotë suspendimin e kryetarit të tillë. Kjo mbyll fazën e parë dhe nis fazën tjetër. Në *fazën e tytë*, Qeveria, brenda një afati prej tridhjetë ditësh (30), mund ta suspendojë kryetarin dhe ta dërgoj lëndën në Gjykatë Kushtetuese. Kur lënda kalon në Gjykatë, atëherë nis *faza e tretë* dhe e fundit. Nëse Gjykata përkrahë vendimin e Qeverisë, atëherë kjo e fundit mund ta bëjë shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës, duke përdorur arsyetimin e Gjykatës, pra jo arsyetimin e vet si organ politik.

11.4. Komente dhe pyetje

11.4.1. Kompetenca **ratione temporis** e Gjykatës lidhet me një prerje kohore të një momenti nga kur nisin të vlejnë dispozitat e Kushtetutës dhe parimet e saj. Kjo prerje nënkupton momentin kohor nga i cili ka filluar të vlej Kushtetuta. Kështu është edhe me juridiksionin **ratione temporis** në kuadër të **GjEDNJ** kundrejt vendeve të reja anëtare të **KEDNJ**. Për dallim nga KEDNJ, në Kushtetutën e vitit 2008 nuk ka dispozita që tregojnë për kompetencën **ratione temporis** të Gjykatës! Çfarë do të thotë kjo? Ku gjenden rregullat mbi kompetencën **ratione temporis** të **Gjykatës Kushtetuese**? A mund të paraqitet një situatë ndaj të cilës Gjykata nuk do të ushtronte, për arsye **ratione temporis**, juridiksionin e saj meritor?

11.4.2. Cilët faktorë kanë qenë përcaktues në përzgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese? A kanë qenë të njëjta përafërsisht edhe në vendet tjera ish-komuniste të Evropës? Kjo pyetje ka rëndësi për t'u ditur sepse nga kjo është varur mjaft shumë edhe cilësia e diskursit publik kosovar rreth vendimeve të Gjykatës në vitet e para formative të kësaj gjyqësie. Mbi bazën e atij diskursi publik, më pastaj, është ndërtuar edhe marrëdhënia e publikut ndaj gjyqësisë kushtetuese. Disa nga këta faktorë janë objektivë dhe lidhen me aspekte materiale dhe sociale të gjyqësisë kushtetuese, kurse tjerët janë subjektiv dhe lidhen me një lloj të caktuar të edukimit juridik në Kosovë dhe në vendet e Evropës ish-komuniste. Për çfarë bëhet fjalë këtu?

11.4.3. Modeli **evropian/keslenian** i gjyqësisë kushtetuese ka shumë variacione, me duzinë kompetencat të gjykatave kushtetuese që e largojnë shumë nga ideja fillestare e **Hans Kelsen**. Sipas kësaj ideje fillestare, gjykata kushtetuese do të kishin juridiksion të kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së ligjeve. Me kalimin e kohës, këto gjykata kanë marrë disa funksione që i kanë larguar nga koncepti fillestar. Për çfarë bëhet fjalë këtu? Për cilat kompetenca të çuditshme të këtyre gjykatave flitet këtu? Ka një funksion, megjithatë, që sot e kësaj dite ngelet i papajtueshëm më fizionominë e gjyqësisë kushtetuese evropiane/kelseniane. Ai ka të bëjë me funksionin këshillëdhënës të gjykatave kushtetuese. Çka do të thotë ky funksion i tyre dhe si duket një gjë e tillë në jurisprudencën e **Gjykatës Kushtetuese**?

11.4.4. Neni 112.1 e përcakton Gjykatën si autoritetin përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. Kjo dispozitë gjendet, me formulim pak a shumë të njëjtë, në të gjitha kushtetutat e vendeve që kanë model evropian/keslenian të gjyqësisë kushtetuese. Në nenin 113.1, ndërkaq, për Gjykatën thuhet se "[…] vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në

mënyrë ligjore nga pala e autorizuar". Cili është dallimi në mes të këtyre dy dispozitave kushtetuese, në veçanti në kontekstin e llojit të vendimmarrjes së Gjykatës? Në këtë kontekst, tregoni për dallimin në mes të objektit të interopretimit dhe parametrave të interpretimit, si dhe në mes të **interpretimit kushtetues** dhe **kontrollit gjyqësor apo kushtetues**, si dhe marrëdhëniet e këtyre dy koncepteve me funksionin këshilldhënës të Gjykatës.

11.4.5. Cili është dallimi në mes të juridiksionit dhe kompetencës? Si manifestohet ky dallim në praktikën e **Gjykatës Kushtetuese** në çështjet që lidhen me nenin 112.1 të Kushtetutës?

11.4.6. Çfarë nënkuptohet me **kontrollin incidental pan-evropian** dhe mbi çka bazohet kjo ide? Pse nuk mund të ekzistojë juridiksioni këshillëdhënës në gjyqësinë kushtetuese kosovare bazuar në nenin 53 të Kushtetutës lidhur me nenin 1.1 të Protokollit 16 të **KEDNJ**? Diskutoni duke u fokusuar në teoretizim të kësaj problematike!

11.4.7. **Kosova** bën pjesë në kuadër të atyre shteteve, si **Gjermania** e **Italia**, ku dhënia e mendimeve këshillëdhënëse, që në përmbajtje janë vendime meritore, **aktgjykime**, ka lindur si rezultat i **aktivizimit gjyqësor** në jurisprudencën e Gjykatës. Gjykata ka arsyetuar këtë qasje me nevojën që t'u ndihmohet organeve qendrore, Presidentit dhe Qeverisë, në ushtrimin e kompetencave të tyre kushtetuese. Çfarë do të thotë kjo? A është kjo e sakët? Thënë ndryshe, a ka në kuadër të nenit 113 të Kushtetutës, që flet për juridiksionin dhe palët e autorizuara, ndonjë dispozitë që autorizon Gjykatën për dhënien e një mendimi këshillëdhënës të detyrueshëm, por që ka formën e aktgjykimit si vendim meritor, me qëllim që t'u ndihmohet organeve qendrore të Shtetit të Kosovës në ushtrimin e funksioneve të tyre kushtetuese? Në përgjigjen e kësaj pyetje, shtjelloni në kontekstin e rasteve të vendosura nga Gjykata, si vijon: rasti i deputetëve serb lidhur me vendet e rezervuara, apo **rasti KO 18/14**, rasti lidhur me imunitetet e funksionarëve të lartë shtetëror të Kosovës, apo **KO rasti 98/11,** dhe, së fundi, rasti i Asociacionit apo **rasti KO 130/15.**

11.4.8. Në rastet kur Presidenti dhe Qeveria paraqiten si palë procedurale në Gjykatë jashtë autorizimeve të tyre nga paragrafët 2 & 3 të nenit 113 të Kushtetutës, atëherë nuk ka objekt të kontrollit kushtetues. Ai objekt në këtë rast mungon sepse nuk ka një ligj, normë apo akt tjetër juridik në kuptim të paragrafëve 2 & 3 të nenit si më sipër. Në vend të objektit real të përshkruar kësisoj të kontrollit kushtetues, i cili këtu mungon, Gjykata si pikë referimi ka marrë dhe merr nevojën e këtyre palëve të privilegjuara për të adresuar pyetje kushtetuese me qëllim të marrjes së sqarimeve lidhur me natyrën juridiko-kushtetuese të kompetencave të tyre kushtetuese nga nenet 84 dhe 93 të Kushtetutës. Në këto raste, Gjykata ka shkrirë objektin e kontrollit kushtetues në parametrat e kontrollit kushtetues, duke i bërë një dhe të vetëm. Si quhet ky silogjizëm gjyqësor, përkatësisht ky operacion mendor (intelektual) i Gjykatës? Çka nënkuptohet me objekt të kontrollit kushtetues dhe çka me parametër të kontrollit kushtetues?

11.4.9. Cilësia e dytë që përcakton fizionominë e Gjykatës, ka të bëjë me juridiksionin e saj nga neni 113 i Kushtetutës. Ky juridiksion përcaktohet qartë me Kushtetutë dhe nuk duhet të caktohet ndryshe nga askush, përfshirë këtu Gjykatën. Edhe atëherë kur thuhet se juridiksioni shtesë përcaktohet me ligj, siç bëhet në paragrafin e fundit të nenit 113 të Kushtetutës, fjala është për një juridiksion që nuk mund të jetë veçse në përputhshmëri me dispozitat kushtetuese që rregullojnë fushën respektive që normohet me ligj si juridiksion shtesë në kuptimin si më sipër (zgjedhjet e përgjithshme dhe vetëqeverisja lokale). Diskuto kuptimin e këtij paragrafi, në veçanti sa i përket tri aspekteve: *i pari*, se juridiksioni përcaktohet qartë me Kushtetutë; *e dyta*, se edhe atëherë kur caktohet me ligj, një caktim i tillë ka bazë në Kushtetutë; dhe, *së fundi*, juridiksioni shtesë në lëmin e zgjedhjeve të përgjithshme që ekziston aktualisht a mund të jetë, në kuptimin të paragrafit të fundit të nenit 113 të Kushtetutës, edhe juridiksion në sferën e kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë.

11.4.10. Siç flasin statistikat e Gjykatës, pjesa dërrmuese e ngarkesës me lëndë i referohet rasteve që kanë të bëjnë me ankesën kushtetuese. Kjo vjen si pasojë e faktit se në Kosovë ekziston mjeti juridik kushtetues i llojit të **ankesës së plotë kushtetuese**. Kjo nuk do të thotë, megjithatë, se në këtë ngarkesë nuk ka një kontroll në procesimin e lëndëve të paraqitura sipas nenit 113.7 (ankesa e plotë kushtetuese). Ky kontroll, që synon filtrimin e lëndëve, dallon nga rasti i a.q. **certiorari** në **SHBA**. Në ndërkohë që **Gjykata Supreme e SHBA**-ve

gëzon të drejtën e diskrecionit që vet të përzgjedhë se cilat raste do t'i fusë në punë, në Kosovë kjo nuk është kështu: secili rast që paraqitet sipas nenit 113.7 të Kushtetutës duhet të procesohet, me përjashtim të rasteve kur flitet për abuzimin e të drejtës për ankesë. Kjo këtu nuk ka rëndësi. Me rëndësi është të kuptohet se ky procesim nuk do të thotë edhe pranueshmëri e secilës kërkesë së procesuar. Ka disa kushte të cilat e bëjnë një kërkesë të pranueshme dhe të cilat duhen plotësuar për të qenë e pranueshme ankesa që përmban kërkesën apo kërkesat e tilla kushtetuese. Diskutoni se çfarë është **ankesa e plotë kushtetuese** dhe cilat janë tri kushtet që duhet të plotësohen për t'u konsideruar e pranueshme një ankesë kushtetuese!

11.4.11. Kufizimi i juridiksionit të Gjykatës që ka ndodhur gjatë kohës së pavarësisë së ur ka pasur të bëjë me kufizimet si pasojë e ekzistimit të dispozitave specifike të natyrës kalimtare të së drejtë materiale kushtetuese kosovare të vlefshme në atë kohë. Këto lloje të kufizimeve kanë qenë imanencë e faktit të thjeshtë se supremacia (epërsia) e Kushtetutës së vitit 2008 nuk ka mundur të vijë në shprehje. Pse? Diskuto!

11.4.12. Amendamenti nr. 14, përkatësisht neni 162 i Kushtetutës përbën bazën juridiko-kushtetuese për themelimin e Gjykatës Speciale. Si i tillë është miratuar me vendimin e **Kuvendit të Republikës së Kosovës** nr. 05-V-139 të datës 3 gusht 2015. Ky amendament dhe legjislacioni përcjellës i nxjerrë në bazë tëtij, coftë ai vendor apo ndërkombëtar, dukshëm kufizojnë juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Në fakt, ky amendament dhe legjislacioni përcjellës për vënien e tij në jetë, vendor dhe ndërkombëtar, efektivisht formojnë një gjykatë të re kushtetuese të Kosovës, me seli në Hagë. Për çka bëhet fjalë këtu? Sqarojeni tërë këtë në detaje!

11.4.13. Cilat janë dy nene kushtetuese, që nuk kanë natyrë operative, të cilat definojnë fizionominë (natyrën) e gjyqësisë kushtetuese kosovare që ushtrohet nga Gjykata Kushtetuese? Në çka konsiston fizionomia e Gjykatës e definuar në këto ato dy nene?

11.4.14. Në teori dhe në praktikë pranohet gjerësisht se vendimet e gjykatave kushtetuese përbëjnë pjesë organike të normave kushtetuese të cilat i interpretojnë. Kjo, për pasojë, nënkupton se vendimet e këtyre gjykatave mund të ndryshojnë vetëm me amendament kushtetues. Një gjë e tillë, në parim, duhet të vlejë edhe për Kosovën. Kjo, megjithatë, ka një përjashtim: në tekstin kushtetues në mënyrë të qartë është sqaruar se amendamentet kushtetuese nuk mund të kryhen nëse janë në kundërshtim me kapitullin II të Kushtetutës. Në jurisprudencën e Gjykatës, ndërkaq, ekziston një praktikë interpretimi kushtetues që e sheh Kushtetutën si një tekst që përbën një tërësi të pandarë dhe organike. Në vendimet e Gjykatës kjo praktikë shprehet me fjalinë germa, fryma dhe shpirti i Kushtetutës marrë si tërësi. Si quhet kjo në doktrinë? Thënë me fjalë tjera, si quhet doktrinarisht qasja e një gjykate kushtetuese që ndalon amendamentimet e pjesëve të caktuara kushtetuese që cenojnë disa norma apo parime kushtetuese që cilësohen si me vlerë më të lartë se tjerat? Kjo ka të bëjë me shtjellimet tona lidhur me nenet 113.9 dhe 144. 3 & 4 të Kushtetutës.

11.4.15. *Në kryerjen e rolit të saj si* **legjislator pozitiv**, Gjykata është e kufizuar me disa standarde të **GjED-Nj**-së, duke pasur në konsideratë që funksioni origjinal i saj është vetëm i një **legjislatori negativ**. Për cilat standarde bëhet fjalë në këtë rast?

11.4.16. Paragrafi i parë i nenit 113 përcakton që Gjykata vendos vetëm për rastet e ngritura para saj në mënyrë ligjore dhe nga pala e autorizuar. Çfarë nënkupton kjo dhe si ka vepruar në praktikë Gjykata lidhur me këtë paragraf?

11.4.17. Në kuptim të nenit 113.2 të Kushtetutës ekzistojnë katër subjekte të autorizuara për të ngritur para Gjykatës çështjen e kushtetutshmërisë së ligjeve, statutit të komunës, dekreteve të presidentit dhe të kryeministrit dhe rregulloreve të qeverisë, që janë: **Kuvendi i Kosovës**, **Presidenti i Republikës**, **Qeveria** dhe **Avokati i Popullit**. Çka nënkuptohet me rregullore të qeverisë: vetëm aktet e përgjithshme apo edhe aktet individuale të këtij organi?

11.4.18. Neni 113.2 i Kushtetutës, në pikën e dytë flet për kontrollin kushtetues të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën. Çka nënkuptohet me fjalët dekret dhe rregullore në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese?

11.4.19. Sipas pikës së parë të nenit 113.3 të Kushtetutës, Gjykata është e autorizuar që të zgjidhë konfliktin për kompetencë kushtetuese në mes të Kuvendit, Presidentit dhe Qeverisë, sipas kërkesës së njërit nga ta. Brenda cilit afat duhet të ushtrohet kjo kërkesë dhe në çka konsiston vendimi i Gjykatës në rastin e zgjidhjes së konfliktit për kompetencë?

11.4.20. Pika e dytë e nenit 113. 3 përcakton juridiksionin e Gjykatës në lidhje me kontrollin e kushtetutshmërisë së referendumit të propozuar. Është e rëndësishme të thuhet që në kuptim të **modelit konsociacional të demokracisë** (**consotiational democracy**) që e vendos Kushtetuta e vitit 2008, kontrolli kushtetues i referendumit është pikë shumë thelbësore për ruajtjen e këtij modeli të demokracisë. Në ushtrimin e këtij juridiksioni, Gjykata duhet që të marrë në konsideratë dy çështje. Diskuto!

11.4.21. Në demokracitë liberale perëndimore, thuajse pa asnjë përjashtim, ekzistojnë dispozita të detajuara lidhur me gjendjen e jashtëzakonshme: **konstitucionalizmi** i aktit të shpalljes si dhe monitorimi i gjendjes dhe veprimeve të kryera më pastaj përbëjnë një shenjë dalluese në mes tyre dhe vendeve autoritare ku apriori nënkuptohet se pushtetit është sovran dhe nuk ka asnjë kufizim serioz juridik-kushtetues. Kosova nuk bën përjashtim në këtë drejtim: neni 113. 3 i Kushtetutës i jep të drejtën asaj për të vendosur lidhur me disa aspekte të **aktit të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme** si dhe të jes së kushtetutshmërisë së gjendjes së jashtëzakonshme marrë si tërësi. Kjo dispozitë duhet të shikohet në lidhje me dispozitat materiale të nenin 131 të Kushtetutës që flet për gjendjen e jashtëzakonshme. Diskuto rolin e Gjykatës në çështjen e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme nga aspekti komparativ!

11.4.22. Bota që nga fundi i vitit 2019 u fut në një gjendje ankthi për një pandemi në pritje. Muajin e parë të vitit 2020, Kina nisi luftën e ashpër kundër një virusi që tronditi botën, virusit **COVID-19**, i njohur edhe si virusi **CORONA**. Ky vend, si origjinë e këtij virusi, për një muaj në vijim mori përmasat e pandemisë, të cilat u shpallën botërisht nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH). Të gjitha shtetet e botës, thuajse pa përjashtim, u afektuar. Në Evropë, në Itali gjatë marsit vdiqën me mijëra njerëz dhe nuk pat shtet në kontinentin e vjetër që nuk mori masa emergjente, një pjesë e tyre edhe masa të gjendjes së jashtëzakonshme të derogimit të lirive dhe të drejtave të garantuara me kushtetuta nacionale. Bashkimi Evropian në fillim nuk pat përpjekje të koncertuara, për t'u konsoliduar në fillim të muajit prill 2020. Përmasat e reagimeve të shteteve ishin në planin global dhe të njëjta.

Kosova nuk bëri përjashtim nga kjo: me Vendimin nr. 01/15 të datës 23 mars 2020, Qeveria e Kosovës futi **masat e emergjencës**. Presidenti i Republikës, ndërkaq, insistonte në shpalljen e **gjendjes së jashtëzakonshme.** Vendimi për masat emergjente u kontestua në Gjykatën Kushtetuese nga ana e **Presidentit.** Argumenti bazik i tij ishte që kufizimet e bëra me vendim të Qeverisë përbënin cenim të nenit 56 të Kushtetutës sepse, sipas tij, masat e Qeverisë mund të merreshin vetëm në rastet kur ekziston shpallja zyrtare e gjendjes së jashtëzakonshme. Qeveria, në anën tjetër, theksonte se kishte të gjitha autorizimet për të bërë kufizimet e të drejtave dhe lirive kushtetuese mund të kufizoheshin sipas nenit të saj 55 Kushtetutës. Krahas këtij neni, Qeveria kishte bazuar vendimin e vet për kufizim të lirive dhe të drejtave kushtetuese edhe në dy ligje të tjera, në **Ligjin nr. 02/L-109** për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse dhe **Ligjin nr. 04/L-125** për Shëndetësi. Këto baza juridike, sipas Qeverisë, e bënin mjaftueshëm të qartë të drejtën e saj për të kufizuar lirinë e lëvizjes, lirinë e tubimit dhe të drejtën e privatësisë, dhe atë në tërë territorin e Kosovës dhe ndaj të gjithë qytetarëve të saj. Ky argument i Qeverisë, megjithatë, nuk u pranua nga Gjykata Kushtetuese: me vendimin e saj **KO 54/20** u shpall jo kushtetues vendimi në fjalë i ekzekutivit të vendit. Gjykata, me po këtë vendim, refuzoi si të pabazuara argumentimet e Presidentit që bazoheshin në nenit 56 të Kushtetutës. Diskutoni! Këtë diskutim duhet ta bazoni në analizimin e tërësishëm të përbashkët në grupe të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin **KO 54/20.**

11.4.23. Në pikën II të pjesës operative të Aktgjykimit në rastin **KO 54/20** thuhet se vendimi i Qeverisë nuk është në përputhshmëri me nenin 56 të Kushtetutës (sic!). A është ky nen bazë e drejtpërdrejtë juridike për vendime të Qeverisë, siç ka vepruar ajo me rastin e nxjerrjes së vendimit të kontestuar që u shpall si jo kushtetues? Apo ky nen shërben si bazë juridike vetëm për Kuvendin me rastin e miratimit të ligjeve që kufizojnë liritë dhe të drejtat e garantuara me Kushtetutë? Përgjigjuni këtyre pyetjeve dhe dilemave, në veçanti

duke e krahasuar këtë rast me analizën e parimit të proporcionalitetit të kryer nga Gjykata në paragrafët 127-175 të rastit **KO 131/12** (*Aktgjykim. Parashtrues: Dr. Shaip Muja dhe 11 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 18, 19,41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi, Nr. 04/L-125, të miratuar nga Kuvendi, më 13 dhjetor 2012*).

11.4.24. Në paragrafin 293 të Aktgjykimit në rastin **KO 54/20**, Gjykata konstaton se çdo masë kufizuese nga Qeveria dhe organet tjera mund të ndërmerret vetëm për aq sa lejohet me ligj të Kuvendit. Pas kësaj bën fjalë për kontrollin dhe balansimin e pushteteve dhe konstaton se "[...] Gjyqësori në këtë trekëndësh pushtetesh e ka rolin e vet për të kontrolluar, në mes tjerash, edhe kushtetutshmërinë e ligjeve të nxjerra nga Kuvendi por edhe kushtetutshmërinë e vendimeve të Qeverisë përmes së cilave zbatohen ligjet e Kuvendit." Ky konstatim i Gjykatës, a është i saktë? Diskutoni!

11.4.25. Pika e katërt e paragrafit të tretë të nenit 113 përcakton juridiksionin e Gjykatës për të kontrolluar përputhshmërinë e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara sipas kësaj Kushtetutës, dhe rishikimin e procedurës së ndjekur. Ky kontroll njihet me emrin **kontrolli i konvencionalitetit** dhe është mjaft i përhapur në vendet e modelit **evropian/kelsenian.** Në **Kosovë**, rasti **kontrollit të konvencionalitetit** mund të vijë në shprehje vetëm në kontekstin e situatës së krijuar me **Gjykatën Speciale**. Diskuto këtë lloj të kontrollit kushtetues në **Kosovë** nga aspekti komparativ!

11.4.26. Neni 113.4 i Kushtetutës e njeh juridiksionin e Gjykatës për të kontrolluar kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve juridike të Qeverisë të cilat cenojnë autoritetin kushtetues të komunave ose zvogëlojnë të hyrat e komunës. Në kuptimin shqip, sikur del nga këtu se Qeveria nxjerr ligje (sic!). Kjo, megjithatë, nuk është kështu. Vetëm versioni origjinal i Kushtetutës së vitit 2008, e jep sqarimin se çka duhet nënkuptuar me ligje dhe akte të Qeverisë të cilat janë objekt i kontrollit kushtetues në kuptim të kësaj dispozite. Kjo procedurë dallon dukshëm nga procedura të cilën mund ta fillojë zëvendëskryetari për komunitete në bazë të nenit 62.4 ["Përfaqësimi në Organet e Pushtetit Lokal"] të Kushtetutës: kjo procedurë sipas nenit 62.4 dallon dukshëm nga procedura sipas nenit 113.4 të Kushtetutës. Diskuto!

11.4.27. Përderisa neni 113.2 e autorizon një të katërtën (1/4) e deputetëve të Kuvendit që të mund të ngritin para Gjykatës çështjen e kushtetutshmërisë së ligjeve brenda afatit gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi, neni 113.5 e autorizon një pakicë deputetësh prej se paku dhjetë (10) vetash, që të iniciojnë para Gjykatës çështjen e kontrollit të kushtetutshmërisë së një ligji apo vendimi të Kuvendit. Cili është dallimi në mes të këtyre dy procedurave të kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë dhe cilat janë cilësitë e secilës prej tyre?

11.4.28. Nen i 113. 6 i Kushtetutës përcakton juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese për të konstatuar nëse **Presidenti i Republikës** ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës. Iniciativa për të ushtruar juridiksionin sipas këtij paragrafi mund të paraqitet nga së paku tridhjetë (30) deputetë të Kuvendit. Në rastin **KI 47/10**, Gjykata ka ushtruar juridiksionin e saj për të kontrolluar nëse Presidenti i Republikës, sipas këtij paragrafi, kishte bërë shkelje serioze të Kushtetutës. Diskuto, në veçanti çështjen e pranueshmërisë së kërkesës në këtë rast dhe esencën e verdiktit të Gjykatës me të cilin ka gjetur shkelje të Kushtetutës nga ana e ish-Presidentit të Republikës, Fatmir Sejdiu!

11.4.29. Përveç juridiksionit abstrakt, përmes së cilit Gjykata bën kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së akteve juridike, kontroll që bëhet sipas aktorëve të privilegjuar institucional sipas neneve të diskutuara më sipër, neni 113.7 i Kushtetutës u jep autorizim individëve për të inicuar shkeljet e të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese të kryera nga autoritetet publike, por vetëm pasi që të kenë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Kjo është dispozita që sanksionon ankesën kushtetuese në sistemin kushtetues kosovar. Tregoni se çka është **ankesa e plotë kushtetuese** dhe çka dallon ajo nga aneksa **jo e plotë kushtetuese**? Cilat janë kushtet e pranueshmërisë së kërkesës së paraqitur përmes ankesës kushtetuese, Përveç kushtit që ka të bëj me shterjen e mjeteve juridike? Cili është dallimi në mes të një **actio popularis** dhe ankesës kushtetuese?

11.4.30. Neni 113.8 përcakton juridiksionin **incidental** të Gjykatës Kushtetuese. Ndryshe, në literaturën komparative, ky juridiksion njihet edhe si **qasja e tërthortë në gjykatë**, çështja paraprake e kushtetutshmërisë etj.

Cilat janë prerogativat e Gjykatës Kushtetuese në këtë rast (caqet e kontrollit kushtetues të rastit të referuar)? Çka nënkuptohet me gjykatë referuese? Çfarë niveli të dyshimit në kushtetutshmërinë e ligjit duhet të ketë gjykata referuese për të dërguar një rast në Gjykatën Kushtetuese përmes rrugës së **kontrollit incidental**? A ka vende kur gjykata referuese është e detyruar që të dërgojë rastin në gjykatë kushtetuese dhe cilat janë ato?

11.4.31. Neni 113.9 përcakton që kryetari i Kuvendit **duhet** të referojë amendamentet e propozuara kushtetuese, para miratimit të tyre në Kuvend, në Gjykatën Kushtetuese për t'i kontrolluar nëse ato zvogëlojnë të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Deri më tani, Gjykata ka bërë kontrollin e kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese në shtatë raste. Cila është praktika e Gjykatës lidhur me këtë? A përfshinë vetëm kapitullin II të kushtetutës apo diçka më shumë? Cila është esenca e Aktgjykimit të Gjykatës në rastin **Jahjaga**? Si quhet kjo doktrinë në literaturën komparative dhe kush e zbuloi për herë të parë?

11.4.32. Sipas nenit 113.10 të Kushtetutës, Gjykata mund të ketë **juridiksion shtesë**, jashtë juridiksionit nga neni 113. Këtu nuk bëhet fjalë për juridiksionin shtesë të përcaktuar me Kushtetutën e vitit 2008, siç është rasti me juridiksionin që lidhet me realizimin e vetëqeverisjes lokale dhe barazinë e komuniteteve të Kosovës. Në këtë kuptim ka qenë juridiksioni që ka ushtruar Gjykata në rastin e Aktgjykimit në rastin **KO 01/09**, i cili është krejtësisht i ndryshëm nga **juridiksioni shtesë** sipas nenit 113.10: në këtë dispozitë flitet për juridiksionin kushtetues që përcaktohet me një ligj (qoftë ai një ligj i zakonshëm apo ndonjë ligj tjetër që miratohet me procedurë të veçantë dhe për çështje të veçanta), pra jo për juridiksionin e përcaktuar me Kushtetutë në kuptim të rastit të vendosur me Aktgjykimin **KO 01/09**. Cilat janë dy ligjet që kanë **përcaktuar juridiksion** shtesë për Gjykatën në kuptim të nenit 113.10 dhe në çka konsiston ai?

11. 5. Lexim shtesë

- David Deener, "Judicial Review in Modern Constitutional Systems" *American Political Science Review* Vol. 46 Issue 4 (1952)
- Bruce Ackerman, "The Rise of World Constitutionalism" *Virginia Law Review* Vol. 83 No. 4 (May, 1997)
- Yuval Shany, How Supreme is the Supreme Law of the Land? Comparative Analysis of the Influence of International Human Rights Treaties Upon the Interpretation of Constitutional Texts by Domestic Courts. *Brooklyn Journal of International Law* Vol. 31 No. 2 (2006)
- Andreas Voßkuhle, "Multilevel Cooperation of the European Constitutional Courts. *Der Europäische Verfassungsgerichtsverbund.*" *European Constitutional Law Review* Vol. 6 (October, 2010)
- EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION), *OPINION ON THREE LEGAL QUESTIONS ARISING IN THE PROCESS OF DRAFTING THE NEW CONSTITUTION OF HUNGARY*. Adopted by the Venice Commission at its 86th Plenary Session (Venice, 25-26 March 2011)
- Milan Podunavac & Biljana Dordevic (eds.), *Ustavi u vremenu krize: postjugoslovenska perspektiva* (Univerzitet u Beogradu – Fakultet politickih nauka: Beograd, 2014)
- Pietro Faraguna, *A Living Constitutional Identity: The Contribution of Non-Judicial Actors* (NYU School of Law. New York, NY, 2015)
- Andreas Voßkuhle, Protection of Human Rights in the European Union. Multilevel Cooperation on Human Rights betëeen the European Constitutional Courts. German Federal Constitutional Court, Karlsruhe, Germany. Session 6, Keynote Lecture: "Human Rights – Global Culture – International Institutions" Our Common Future, Hannover, November 4, 2010. Në internet: http://www.ourcommonfuture.de/fileadmin/user_upload /dateien/Reden/Vosskuhle.pdf (shikuar në shkurt 2018).

12. CAKTIMI I GJYQTARËVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE DHE STATUSI I TYRE

Përgjithësisht. - Në këtë kapitull flasim për caktimin e gjyqtarëve kushtetues në Kosovë dhe statusin e tyre. Në seksionin e parë ndalojmë tek periudha e pavarësisë së mbikëqyrur sepse në këtë kohë ka vlejtur supremacia (epërsia) e **Planit Ahtisari**, jo e Kushtetutës së Kosovës të vitit 2008. Në këtë periudhë të zhvillimit të konstitucionalizmit kosovar ekzistojnë shumë specifika sa i përket juridiksionit ashtu dhe mënyrës së caktimit të gjyqtarëve kushtetues ndërkombëtar. Sikundër dihet, në **GJKRKS** kanë punuar tre gjyqtarë ndërkombëtar, njëjtë si në **Bosnje-Hercegovinë**, si dhe disa këshilltarë ligjor. Në fakt, tre gjyqtarët ndërkombëtar kanë ardhur në **Kosovë** përmes **Bosnjë-Hercegovinës**, përkatësisht kjo e fundit ka qenë stacioni i fundit i postimit të tyre para ardhjes në **Kosovë**. Mënyra e vënies së tyre në postin e gjyqtarit kushtetues, si dhe të këshilltarit ligjor ka qenë mjaft specifike. Ka rëndësi që lexuesi t'i kuptojë këto specifika si dhe dinamikat që janë zhvilluar në **Gjykatën Kushtetuese** gjatë kohës sa ata kanë punuar aty. Në këtë kontekst, ka rëndësi që lexuesi dhe historia e gjyqësisë kushtetuese në Kosovë të ruajë një memorie shkencore të sjelljeve skandaloze dhe tërësisht joprofesionale të njërit prej gjyqtarëve ndërkombëtarë, **Robert Carolan**, i cili, me një dëshmi të rrejshme, persekutoi përmes gjyqit ish kolegun e vet, autorin e parë të këtij libri. Këtë sqarim, krejtësisht shkencor dhe të bazuar në fakte të rastit, e japim në seksionin e parë në vijim, si dhe në seksionet që flasin për imunitetin e gjyqtarëve kushtetues.

Çdo sqarim në këtë kapitull ka karakter komparativ, siç kanë pasur të gjitha sqarimet tona deri këtu dhe do të kenë më tutje. Kjo bëhet me qëllim të vënies së zgjidhjeve kosovare teorike dhe praktike në një kontekst më të gjerë dhe më universal. Kjo periudhë përfshin edhe seksionin e dytë, në të cilin diskutojmë caktimin e gjyqtarëve kushtetues, vendor dhe ndërkombëtar, pas mbarimit të pavarësisë së mbikëqyrur në shtator të vitit 2012. Sa i përket specifikave të juridiksionit kushtetues gjatë kohë së pavarësisë së mbikëqyrur, kujtojmë lexuesin se atë çështje e kemi diskutuar në kapitullin pararendës.

Në kuadër të dy seksioneve të para që trajtojnë zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetues, kushtet dhe procedurat e zgjedhjes, një rëndësi e veçantë i kushtohet kualifikimeve që kërkohen për të qenë gjyqtarë kushtetues. Nga ky trajtim qartë vërehet se **Kosova** i takon pjesës dërrmuese të vendeve që modelohen sipas llojit **kelsenian/evropian** të gjyqësisë kushtetuese. Në këtë mes bëjmë krahasimin e **Kosovës** me disa vende të tjera, siç janë, ta zëmë, **Franca**, ku gjyqtarët kushtetues mund të mos jenë juristë, apo **Austria**, ku lejohet **instituti i kooptimit** të gjyqtarëve kushtetues, si dhe shumë gjëra si këto që hedhin dritë në anën komparative të gjyqësisë kushtetuese kosovare.

Statusi i gjyqtarëve kushtetues të **Kosovës** ka zënë një vend të posaçëm në trajtimet tona në seksionin e tretë, ku në disa nënseksione i shkoqisim një nga një segmentet kryesore të trajtave në të cilat reflektohet statusi i gjyqtarëve kushtetues kosovarë. Në rend të parë e veçojmë çështjen e papajtueshmërisë së funksionit të gjyqtarit kushtetues me disa profesione dhe aktivitete të tjera, kryesisht të natyrës politike dhe shtetërore. Këtë kategori e vejmë në dritën komparative, përkatësisht kundrejt zgjidhjeve dhe praktikave kushtetuese gjetiu në **Evropë** dhe më gjerë. Edhe në këtë pikë **Kosova** nuk dallon nga pjesa dërrmuese e vendeve të botës liberale perëndimore, në veçanti nga ish-vendet komuniste dhe vendet tjera që kanë model **kelsenian/evropain** të gjyqësisë kushtetuese: përveç aktivitetit të ligjërimit apo aktivitetit shkencor e hulumtues, artistik dhe krijues, veprimtaritë tjera shtetërore dhe politike konsiderohen si rreptësisht të papajtueshme me funksionin e gjyqtarit kushtetues.

Një aspekt tjetër me rëndësi në lidhje me statusin që trajtohet në këtë kapitull është ai i privilegjeve dhe imuniteteve të gjyqtarëve kushtetues. Në këtë segment gjithashtu tehun e analizës e drejtojmë kah ana komparative dhe gjejmë se **Kosova** nuk bën përjashtim nga tjerët: shumica e privilegjeve që kanë gjyqtarët kushtetues kosovarë, janë larg më të vogla dhe më të pakta se ato të vendeve të tjera ish-komuniste, në të cilat bën pjesë **Kosova**. Sa i përket imuniteteve, ndërkaq, gjendja qëndron më ndryshe: **Kosova** ka përqafuar në Kushtetutën e vitit 2008 kategorinë e **imunitetit funksional**, një standard ky i rekomanduar fuqishëm nga ana e **Komisionit të Venecias** dhe i përqafuar në pjesën dërrmuese të vendeve ish-komuniste të Evropës dhe më gjerë, si dhe në vendet e demokracive tradicionale në **Evropë** (me përjashtim të **Italisë**). Këtu tregojmë se disa vende nuk kanë fare dispozita mbi imunitetin e gjyqtarëve kushtetues dhe gjyqtarëve të tjerë të barasvlershëm më ta.

Në analizën tonë shkencore të secilës prej formave të manifestimit të përbërësve të statusit të gjyqtarit kushtetues, si dhe kushteve dhe mënyrës së caktimit të gjyqtarëve kushtetues (dhe gjyqtarëve tjerë të barasvlefshëm me ta) ekziston një qasje e theksuar komparative. Këtë e bëjmë me qëllim që lexuesi vetë të gjejë vendin e **Kosovës** në universin evropian dhe më gjë të gjyqësisë kushtetuese. Një arsye konstante që rri si hije për qasje tonë komparative ka të bëjë me vetë natyrën dhe përmbajtjen e Kushtetutës së vitit 2008, historinë e krijimit të saj dhe vetë misionin historik që ajo ka në ndërtimin e një identiteti të ri kushtetues kosovar.

Dy seksionet e fundit, njëjtë si në krejt kapituj tjerë, janë të rezervuar respektivisht për komente dhe pyetje dhe për literaturën shtesë që ka të bëj me këtë kapitull.

12.1. Zgjedhja gjatë kohës së pavarësisë së mbikëqyrur

Deri në qershor të vitit 2018, krahas **Bosnje-Hercegovinës**[1] dhe **Lihtenshtajnit**,[2] **Kosova** ka qenë vendi i tretë në **Evropë** që ka pasur në përbërjen e vet tre gjyqtar ndërkombëtar. Prania e gjyqtarëve ndërkombëtarë, temë që diskutohet në vijim të këtij seksioni, ka pasur natyrë të përkohshme. Përndryshe, **kriteri i shtetësisë** përbën një ndër kriteret kyçe dhe një standard përgjithësisht i përqafuar, jo vetëm

[1] Në rastin e **Bosnje - Hercegovinës** tre nga gjyqtarët kushtetues nuk mund të jenë shtetas të këtij vendi dhe të asnjë vendi tjetër fqinjë me të. Këta tre gjyqtarë, të cilësuar si "gjyqtarë ndërkombëtar", caktohen nga kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (**GJEDNJ)**. Ky stipulim kushtetues, i parashikuar në nenin VI të **Kushtetutës së Bosnje-Hercegovinës** është pjesë e detyrimit ndërkombëtar të marrë nga ky vend me **Marrëveshjen e Dejtonit** (nëntor 1995): **Kushtetuta e Bosnje-Hercegovinës** është pjesë integrale e **Marrëvështjes së Dejtonit** dhe gjendet në aneksin e saj të katërt. Cf. për tekstin e plotë të **Marrëveshjes së Dejtonit**, botuar në **The General Framework Agreement for Peace in Bosnia and Herzegovina**. **Initialled in Dayton on 21 November 1995 and signed in Paris on 14 December 1995.**
Në internet https://www.osce.org/bih/ 126173?download=true (shikuar në mars 2018); Për komentet doktrinare të këtij stipulimi dhe rolin e gjyqtarëve ndërkombëtar në këtë vend, cf. Alex Schwartz and Melanie Janelle Murchison "Judicial Impartiality and Independence in Divided Societies: An Empirical Analysis of the Constitutional Court of Bosnia – Herzegovina" *Law & Society Review*, Vol. 50, No. 4 (2016) fq. 821-855 në fq. 824-830 (ku autori diskuton rolin e gjyqtarëve ndërkombëtarë, në veçanti në vendimet e rëndësishme që kanë ndarë trupin gjykues përgjatë vijave etnike dhe gati kanë paralizuar Gjykatën; autori u njeh në veçanti meritat këtyre tre gjyqtarëve ndërkombëtar për vendimet që kanë pasur të bëjnë me garantimin e barazisë së tri kolektiviteteve në nivel shtetëror, pra jo me barazinë e entitetve, sepse një praktikë e tillë në **Republika Srpska** në thelb përjashtonte barazinë e çdo joserbi; ky vendim ka bërë që tre popujt të kenë status të njëjtë dhe të barabartë në tërë territorin e **Shtetit të Bosnje-Hercegovinës**).

[2] Në rastin e **Lihtenshtajnit**, praktika është që një gjyqtar vjen nga **Austria** dhe një tjetër nga **Zvicra.** Ky përcaktohet me nenin 105 të **Kushtetutës së Lihtenshtajnit** që përcakton se shumica e dhjetë gjyqtarëve (pesë nga ta janë gjqytarë rezervë) duhet të jenë shtetas të **Lihtenshtajnit.** Kjo është pjesë përbërese të historisë kushtetuese të kësaj principate.Vendi është monarki kushtetuese parlamentare e trashëgueshme. Cf. për tekstin e Kushtetutës në **Constitution of the Principality of Liechtenstein of 5 October 1921**. As of: 1 February 2014.
Në internet:file:///C:/Users/vatani/Downloads/Liechtenstein_Constitution_am2014_eng%20(1).pdf (shikuar në mars 2018); Cf. **Conference of European Constitutional Courts**, XIIth Congress (2002). *The relations between the Constitutional Courts and the other national courts, including the interference in this area of the action of the European courts.* Report of the State Court of Justice of **Principality of Liechtenstein** by Prof. Dr. Andreas Kley. (ku autori flet për aktivitetin mjaft të pasur në planin ndërkombëtar të kësaj gjykate, e cila vepron si gjykatë e lartë e drejtësisë në çështje kushtetuese). Në internet: http://www.confeuconstco.org/reports/rep-xii/Liechtenst ein-EN.pdf (shikuar në mars 2018); Cf. po ashtu edhe **në European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission),** *The Composition of Constitutional Courts*, paragrafi 2.1 ["Eligibility Requirements"].

në modelin **kelsenian/evropian** të gjyqësisë kushtetuese, por edhe më gjerë. Përveç këtij kushti, kushtit të shtetësisë, kushtet e tjera të përcaktuara me kushtetutë dhe ligj kanë vlejtur për të gjithë gjyqtarët kushtetues, si për vendorët ashtu dhe për ndërkombëtarët, në të gjitha fazat e zhvillimit të **Gjykatës Kushtetuese**.

Vlen të theksohet se kushti shtetësisë përcaktohet me **Ligjin nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës** (Ligji nr. 03/L-121),[3] jo me Kushtetutën e vitit 2008.[4] Kjo qasje kosovare përbën një standard mjaft të përhapur: njëjtë si në vendet tjera, përmes ligjeve organike apo ligjeve të tjera të zakonshme, si dhe rregullave të brendshme që normojnë organizimin dhe punën e gjyqësisë kushtetuese përcaktohen kritere shtesë lidhur me stafin, organizimin e jetës dhe punës në gjykatën kushtetuese. **Ligji nr. 03/L-121** dhe **Rregullorja e Punës (RP)** duhet parë në këtë dritë, pra si dy instrumente juridike që shërbejnë për të operacionalizuar dispozitat kushtetuese dhe për të vënë kritere dhe kushte të tjera shtesë për të qenë gjyqtar kushtetues, si dhe standarde shtesë lidhur me organizimin e jetës dhe punës në **Gjykatën Kushtetuese.**

Përbërja e përzier e gjykatave të sipërcekura kushtetuese të **Lihtenshtajnit** dhe **Bosnje-Hercegovinës**, si dhe në rastet tjera të gjyqësorit të rregullt, në literaturë cilësohet si **gjyqësi hibride**. Kjo lloj gjyqësie i referohet si gjyqësorit të rregullt ashtu edhe gjyqësisë kushtetuese si dhe pjesëve të tjera të sistemit të drejtësisë dhe organeve të zbatimit të ligjit. Historikisht shikuar, megjithatë, **gjyqësia hibride**, më shumë identifikohet me juridiksionin në lëmin penal. Në lëmin e gjyqësisë kushtetuese, **gjyqësia hibride** në territorin ish-jugosllav nis me **Bosnje-Hercegovinën**. Koncepti i hibriditetit në gjyqësi, përfshirë gjyqësinë kushtetuese, ka të bëjë jo vetëm me përbërjen e gjykatave vendore, ku përfshihen gjyqtarët ndërkombëtarë krahas atyre vendorë, por edhe me aspektet funksionale të kompetencës lëndore (materiale) të **gjykatave hibride**, që ka të bëjë me zbatimin e të drejtës vendore dhe të drejtës ndërkombëtare në të njëjtën kohë. Përveç këtyre dy cilësive dalluese të gjyqësisë hibride, ekziston edhe një tjetër cilësi dhe ka të bëjë me mënyrën e themelimit të gjykatave hibride: çdoherë themelimi i tyre bëhet bazuar në një marrëveshje me shtetin e pranimit.[5] Të gjitha këto bëhen me një qëllim. Ai qëllim ka të bëjë me ngritjen e kapaciteteve dhe legjitimitetit të gjyqësorit vendor në situatat pas konfliktit në sytë e popullsisë vendore, si dhe me promovimin e sundimit të ligjit në përpjekjet e përgjithshme nacionale për ndërtim të bazës për një stabilitet afatgjatë në gjyqësor dhe në politikë.

Kjo lloj gjyqësie, historikisht shikuar, ka dy forma manifestimi: formën **organike** dhe formën **qëllimore**. Forma organike konsiston në urëzimin e dallimeve në mes të identiteteve të ndryshme vendore dhe atyre ndërkombëtare, duke krijuar një hapësirë institucionale ku

---

3 Neni 4 ["Kushtet shtesë për emërimin e gjyqtarëve"] i **Ligjit nr. 03/L-12:**
"1. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të jenë:
1.1. shtetas të Republikës së Kosovës;
1.2. jurist të shquar me reputacion të shkëlqyeshëm profesional me jo më pak se dhjetë (10) vjet përvojë pune profesionale veçanërisht në fushën e së drejtës publike dhe kushtetuese të dëshmuar, *mes tjerash,* përmes punës profesionale si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, shërbyes civil ose mësimdhënës universitar dhe punë tjera të rëndësishme të natyrës juridike;
1.3. individ me reputacion të shkëlqyeshëm moral, të cilët kanë aftësi të plotë veprimi dhe të cilët nuk janë dënuar për vepër penale."

4 Neni 114 ["Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese"] i Kushtetutës:
"1. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga nëntë (9) gjyqtarë, të cilët do të jenë juristë të shquar dhe personalitete me moralin më të lartë, jo me më pak se dhjetë (10) vjet përvojë profesionale përkatëse. **Kualifikimet e tjera përkatëse rregullohen me ligj.** Parimet e barazisë gjinore do të respektohen […]".

5 Cf. më shumë për këtë në Fisnik Korenica, Argjend Zhubi, Dren Doli, "The EU-engineered hybrid and international specialist court in Kosovo: How 'special' is it? *European Constitutional Law Review* Vol. 12 Issue 3 (December 2016), fq. 474–498 në fq. 474 (fusnota nr. 1, ku autorët i referohen nomenklaturës nga banka e të dhënave për krimin ndërkombëtar, në të cilat bën pjesë **gjyqësia hibride**, si dhe fusnota nr. 2 ku autorët tregojnë për rastet e gjykatave hibride në lëmin penal në **Bosnje-Hercegovinë**, **Sierra Leone**, Timorin Lindor, Kamoxhë dhe Liban).

kontestimet janë produktive dhe ku akterët angazhohen mbi baza të barazisë dhe respektit të ndërsjellë. E kundërta e kësaj, gjyqësia hibride qëllimore dështon në urëzimin e perspektivave kundërthënëse në mes të vendorëve dhe ndërkombëtarëve, duke krijuar kështu një kufi permanent në mes të dallimeve dhe kundërthënieve ekzistuese.[6] Në Kosovë, gjatë kohës së pavarësisë së mbikëqyrur është kultivuar lloji i gjyqësisë hibride organike, si në nivel të gjyqësorit të rregullt ashtu dhe në nivel të gjyqësisë kushtetuese. Kjo ka qenë kështu përkundër faktit se gjatë pavarësisë së mbikëqyrur, autoritetet ndërkombëtare kanë pasur fuqi ekzekutive të pafund, të cilat nuk i kanë shfrytëzuar asnjëherë. Përkundrazi, autoritetet në fjalë janë kujdesur që të ketë një bashkëpunim me vendorët me qëllim të ndërtimit të kapaciteteve dhe ngritjes së sundimit të ligjit dhe stabilitetit në vend.[7]

Kanë qenë tre gjyqtarë ndërkombëtarë. Kushtet për zgjedhjen e tyre i ka caktuar dhe vlerësuar vetë faktori ndërkombëtar në Kosovë. Kjo është arsyeja që në këtu shumë pak mund të tregojmë për kredencialet e tyre akademike dhe morale/etike. Përzgjedhja e tyre është bërë në mënyrë jo transparente dhe pa ndonjë dijeni të publikut kosovar.[8] Baza juridike për një procedurë të tillë ka qenë e përcaktuar fillimisht me **Planin Ahtisari**,[9] bazë e cila më pastaj është transformuar në bazë kushtetuese[10] dhe ligjore.[11] Kjo ka vlejtur edhe pas vitit 2012, kur u mbyll pavarësia e mbikëqyrur e Kosovës, kur një amendament kushtetues kosovar ka shërbyer si bazë për vazhdim për dy vitet në vijim të mandatit të gjyqtarëve ndërkom-

---

6 Steven Hill & Paul Linden-Retek, "Supervised Independence and Post-Conflict Sovereignty: The Dynamics of Hybridity in Kosovo's New Constitutional Court". *The Yale Journal of International Law Online* Vol. 36 No. 38 (Fall 2010) fq.26-43 në fq. 28-29. Në internet: https://cpb-us-w2.wpmucdn.com/campuspress.yale.edu/dist/8/15_81/files/_2017/01/0-36-hill-linden-retek-hybridity-in-kosovo-1tnty08.pdf (shikuar në prill 2018).

7 Ibid., fq. 32-34 (ku autori shpjegon dështimin e administratës ndërkombëtare në Kosovë, **UNMIK**, për të ndërtuar **gjyqësi hibride për shkak të kultivimit të kulturës së varësisë ndaj vendorëve, si dhe frymën e bashkëpunimit të ndërtuar nga ndërkombëtarët gjatë pavarësisë së mbikëqyrur).**

8 Me 12 qershor 2009, Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (**PCN)** emëroi tre gjyqtarë ndërkombëtarë në Gjykatë për një periudhë trevjecare. Cf. Vendimi Nr. 2009/09, Vendimi Nr. 2009/10 dhe Vendimi Nr. 2009/11, të cilat gjenden në akrivën e **Gjykatës Kushtetuese.** Këta gjyqtarë kanë qenë, sipas senioritetit: **Robert Carolan**, **Almiro Rodrigues** dhe **Snezhana Botusharova**. Në literaturë është vërejtur se prezenca e tyre ka qenë paraparë me qëllim të frenimit dhe pengimit të impulsive anti-minoritare të gjyqtarëve vendor: tre gjyqtarë ndërkombëtar dhe dy vendor nga komunitetet kanë qenë vota shumicë kundrejt gjyqtarëve shqiptarë. Kjo, megjithatë, me kalimin e kohës, nuk doli të jetë kështu: asnjë vendim në gjashtë vitet e para sa ka qenë kryetar i Gjykatës autori i parë të këtij libri nuk ka pasur vendime ku janë ndarë votat përgjatë vijave etnike apo në linjën **vendorë vs. ndërkombëtarë**. Cf. Steven Hill & Paul Linden-Retek, "Supervised Independence and Post-Conflict Sovereignty", fq. 35-36, 39-41, si dhe fusnotën nr. 44 në fq. 35 (ku citohen vendimet për emërimin e tre gjyqtarëve ndërkombëtar si më sipër). Cf. edhe Andrea Lorenzo Capussela, "A Critique of Kosovo's Internationalized Constitutional Court". *European Diversity and Autonomy Papers*. *EDAP* 02/2014, fq. 5-41 në fq. 5-6. Në internet: www.eurac.edu/edap (shikuar në prill 2018) (ku autori mbron tezën, pa ndonjë provë të prekshme, sipas së cilës gjyqtarët ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese kanë shërbyer për të zgjatur jetën pranisë ndërkombëtare në Kosovë, përkatësisht për të zgjatur pavarësinë e mbikëqyrur në Kosovë); Njejtë edhe në Andrea Lorenzo Capussela, *State – Building in Kosovo. Democracy, Corruption and the EU in the Balkans* (I.B. Tauris: London and New York, 2015) fq. 164.

9 **Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës**, 2 shkurt 2007 (**Plani Ahtisari**).

10 Neni 152. 4 & 5 ["Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese"] i Kushtetutës:
Deri në fund të mbikëqyrjes ndërkombëtare të zbatimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, Gjykata Kushtetuese do të përbëhet si në vijim:
"[...] 4. Tre (3) gjyqtarë ndërkombëtarë do të emërohen nga Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil pas konsultimit me Kryetarin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Tre (3) gjyqtarët nuk do të jenë qytetarë të Kosovës dhe as të ndonjë vendi fqinj.
5. Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil do të përcaktojë se kur skadon mandati i gjyqtarëve ndërkombëtarë, dhe gjyqtarët do të ndërrohen sikur është e parashikuar me Kushtetutë".

11 Kreu IV - Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare - Neni 55 ["Përbërja e përkohshme e Gjykatës Kushtetuese"] i **Ligjit nr. 03/L-121**:
"1. Për periudhën e përcaktuar në nenin 152 të Kushtetutës, përbërja e Gjykatës kushtetuese do të jetë sikurse është përcaktuar në atë nen.
2. Asgjë në këtë ligj, përfshirë dispozitat të cilat rregullojnë kriteret për përshtatshmëri, kualifikime profesionale dhe kompensim për gjyqtarët, nuk aplikohen për të penguar apo ndryshe kufizuar kompetencat dhe përgjegjësitë e autoriteteve kompetente për emërimin e gjyqtarëve ndërkombëtar, të përcaktuar në Kushtetutën dhe Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Republikës së Kosovës, të datës 26 mars 2007. Këto përgjegjësi dhe kompetenca ushtrohen në pajtim me instrumentet e aplikueshme pavarësisht ndonjë dispozite të këtij ligji."

bëtarë në Gjykatën Kushtetuese.[12] Amendamentimi në fjalë nuk ka pasur më këtë rol në qershorin e vitit 2014: amendamenti i vitit 2012 ka folur vetëm për vazhdim të mandatit për kohën e mbetur shtesë të personave të emëruar nga **PCN**, kurse më vonë, në qershor të vitit 2014, siç do të shihet, mandati i gjyqtarëve kushtetues ndërkombëtarë është vazhduar përmes teknikave të tjera juridike, të njohura si **letërkëmbimet**. E përbashkëta e shkëmbimit të letrave dhe e amendamentit kushtetues si bazë për caktim të gjyqtarëve ndërkombëtarë qëndron në atë se, në dy rastet synohet shmangia, anashkalimi i Kuvendit si propozues i gjyqtarëve kushtetues. Sikundër dihet, propozimi në Kuvend kryhet me zgjedhje (votim). Në rastin e parë, shmangia e procedurave vendore për caktim të gjyqtarëve ndërkombëtarë ka qenë e plotë sepse është anashkaluar në tërësi procedura e zgjedhjes në Kuvend dhe procedura e emërimit (dekretimit) nga Presidenti i Republikës. E kemi fjalën për kohën e pavarësisë së mbikëqyrur dhe caktimin e gjyqtarëve ndërkombëtarë nga viti 2009-2012, si dhe rimandatimin e tyre për dy vitet në vijim (2012-2012). Në rastin e dytë, anashkalimi nuk është i plotë: përmes letërkëmbimit bëhet vetëm anashkalimi i Kuvendit, si propozues i gjyqtarëve kushtetues përmes zgjedhjes (votimit), duke ruajtur procedurën e emërimit (dekretimit) nga ana e **Presidentit të Kosovës**. Këto procedura në tërësinë e tyre dhe dallimet ndërmjet veti i diskutojmë në vijim të këtij seksioni dhe të atij që e pason.

Sikundër është sqaruar në kapitullin pararendës, **Plani Ahtisari** në aspektin juridik ndërkombëtar paraqet një deklaratë të njëanshme të Kosovës në të cilën mund të bazohet çdokush në bashkësinë ndërkombëtare për të realizuar një të drejtë eventuale që mund të burojë nga ky dokument. Kjo nënkupton se ato pjesë të tij që nuk i ka tejkaluar koha, mund të vihen në jetë në mënyrë të drejtpërdrejtë nëse kanë natyrë të vetekzekutueshme. Të kësaj natyre janë, ta zëmë, dispozitat e tij që kanë të bëjnë me sistemin zgjedhor në Kosovë, liritë dhe të drejtat e komuniteteve, ndryshimin e kushtetutës, si dhe dispozitat tjera, të cilat nuk janë të tejkaluara kohërisht. Nuk ka rëndësi nëse dispozitat e **Planit Ahtisari** janë bartur apo jo në Kushtetutën e vitit 2008: ato kanë efektet **erga omnes,** pa një kufi kohor, sepse janë detyrim të cilin Kosova e ka marrë njëanshëm kundrejt bashkësisë ndërkombëtare.

Dispozitat e këtij dokumenti që kanë të bëjnë me zgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve ndërkombëtarë, bëjnë pjesë në ato dispozita juridike të cilat i ka shkelur koha dhe i takojnë historisë kushtetuese të Kosovës bashkëkohore. Si të tilla, ato kanë qenë dispozita mjaft të detajuara dhe nuk kanë lënë vend për ndonjë dykuptimësi sa i përket fizionomisë hibride të gjyqësisë kushtetuese **kelseniane/evropiane** që parashikohej të instalohej në **Kosovë** pas fitimit të pavarësisë. Në to parashikohej caktimi i tre gjyqtarëve ndërkombëtar, duke anashkaluar Kuvendin e Kosovës, i cili bën propozimin e gjyqtarëve kushtetues përmes zgjedhjes, si dhe Presidentin, i cili në fund bën emërimin (dekretimin) e tyre formal. Këto dispozita lidhur me caktimin e gjyqtarëve ndërkombëtarë, megjithatë, nuk i kanë dhënë Gjykatës një fizionomi **kelseniane/evropiane**: ato vetëm kanë shtuar një cilësi dalluese duke e bërë **një gjykatë kushtetuese hibride**. Kanë qenë dispozitat e tjera të aneksit I të **Planit Ahtisari** ato që kanë ngërthyer dispozita kushtetuese përmes së cilave, përfundimisht, në Kosovë është siguruar futja e modelit **kelsenian/evropian** të gjyqësinë kushtetuese pas fitimit të pavarësisë së vendit. E kemi fjalën këtu për dispozitat e pikave dy dhe tre të nenit 6 të aneksit I të Planit, që përcaktonin si vijon:

---

[12] Amendamenti kushtetues nr. **22**, miratuar me **Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës**, nr. 04- V- 436 të datës 7 shtator 2012, *Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20 dt. 5 gusht 2015,* ka përcaktuar si vijon:
"Individët e emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, në pajtim me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit te Kosovës, të datës 26 mars 2007, mandati i të cilëve nuk ka përfunduar para deklarimit të përfundimit të pavarësisë se mbikëqyrur do të vazhdojnë të kryejnë funksionet e tyre në institucionet ku janë deri në fund të mandatit të specifikuara. Kosova do t'ua japë këtyre individëve të njëjtat privilegje dhe imunitete që i gëzojnë diplomatët dhe familjet e tyre sipas Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike".

"[…] 6.2 Dhjetë apo më shumë deputetë të Kuvendit, mes tjerash, do të kenë të drejtën që të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji apo vendimi të miratuar nga Kuvendi para Gjykatës Kushtetuese, si në aspektin përmbajtësor ashtu edhe për procedurës.

6.3. Komunat mund të kontestojnë para Gjykatës Kushtetuese, kushtetutshmërinë e ligjeve apo akteve të qeverisë të cilat cenojnë përgjegjësitë e tyre apo zvogëlojnë të hyrat e tyre".

Ky përcaktim i **Planit Ahtisari**, krahas përcaktimit tjetër të po këtij neni që bënte fjalë për kushtin që duheshin plotësuar kandidatët për t'u zgjedhur gjyqtarë kushtetues, përbën, në fakt, vetë esencën e modelit **kelsenian/evropian** të gjyqësie kushtetuese, përkatësisht cilësinë e përbashkët të të gjitha formave të manifestimit të **modelit kelsenian/evropian** të gjyqësisë kushtetuese. Përveç kontrollit abstrakt të normës juridike dhe kushtit themelor të të qenit jurist për t'u zgjedhur gjyqtar kushtetues, dhe që paraqiten si cilësi të njëjta në modelet **kelseniane/evropiane** të gjyqësisë kushtetuese, ekziston edhe një tjetër cilësi e përbashkët e kësaj gjyqësie. Ajo ka të bëjë me ngjashmërinë e kushteve nën të cilat ekziston dhe vepron gjyqësia **keseniane/evropiane**. Kjo është një cilësi shumë e rëndësishme e përbashkët e formave të manifestimit të modelit **kelesnian/evropian** të gjyqësisë kushtetuese.[13] Kjo cilësi, e cila ka natyrë ekzistenciale për një gjyqësi konkrete kushtetuese, ka të bëjë ngjashmërinë e kushteve nën të cilat krijohen dhe veprojnë gjykatat kushtetuese në shtetet konkrete veç e veç. Brendia e kësaj cilësie i referohet, në rend të parë, natyrës së sistemit qeverisës: gjykatat kushtetuese të tipit **kelsenina/evropian** kanë lindur dhe ekzistojnë në vendet që në të njëjtën kohë kanë një sistem parlamentar (ta zëmë, **Belgjika**, **Gjermania, Italia**, **Spanja,** etj.) ose gjysmë-parlamentar (**Austria**, **Franca**, **Portugalia**, etj.) dhe një pluralizëm të juridiksioneve.

Austria, **Belgjika**, **Franca**, **Italia**, **Portugalia** dhe **Spanja** kanë dy rende të juridiksioneve (gjyqësor dhe administrativ), **Greqia** tre sosh, kurse **Gjermania** pesë.[14] Në këto vende, në krye të secilit juridiksion ekziston një gjykatë supreme apo gjykatë e lartë e fundit në hierarkinë respektive brenda juridiksionit përkatës. Në këtë kontekst duhet parë gjykatat kushtetuese në vendet e demokracive kushtetuese perëndimore të proveniencës liberale, si organe shtetërore të ndara nga këto juridiksione dhe nga çdo organ tjetër shtetëror, dhe të veshura me një juridiksion ushtrimi i të cilit ka për qëllim primar dhe të vetëm sigurimin e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës dhe sigurimin e respektit të saj nga të gjitha juridiksionet dhe organet tjera shtetërore. Kjo ndarje e juridiksionit kushtetues nga juridiksionet tjera bëhet vetëm përmes përcaktimit shprehimor kushtetues, i cili ua njeh gjykatave të veçanta kushtetuese autorizimet e plota dhe të padelegueshme për kontroll

---

13 Louis Favoreu & Wanda Mastor, *Les cours constitutionnelles* (DALLOZ: Paris, 2016) fq. 19-28.
Krahas këtyre dy cilësive të përbashkëta të krejt gjykatave kushtetuese, ekzistojnë edhe disa cilësi të tjera të veçanta që burojnë nga specifikat e secilit sistem kushtetues të përcaktuar me kushtetutë. Mundësinë e ekzistimit të dallimeve në mes të kompetencave konkrete brenda modelit **kelsenian/evropian** të gjyqësisë kushtetuese e ka parashikuar vetë **Hans Kelsen** (Hans Kelsen: 1881-1973). Nga një analizë e këtyre kompetencave konkrete, të përcaktuara me kushtetutë, lehtë mund të vërehen gjykatat kushtetuese që kanë kompetenca të privilegjuara, të cilat i bëjnë të dallueshme nga njëra tjetra. Në këtë drejtim duhen veçuar cilësitë e veçanta, ta zëmë, të **Gjermanisë**, **Italisë** dhe **Austrisë**: **Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë** (GJKGJe) njihet për **ankesën e saj të plotë kushtetuese** dhe rekordin në vendimmarrje në procedurat sipas ankesës kushtetuese në fushën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut; **Gjykata Kushtetuese e Italisë** (GJKIt) ka një cilësi të kundërt me këtë: vendimmarrja shumë e sofistikuar e **GJKIt** në fushën e **kontrolit incidental** kalon çdo gjykatë tjetër në **Evropë** dhe e bën kampion në këtë aspekt; **Austria** me gjykatën e saj kushtetuese ka një cilësi po ashtu të veçantë, kontrollin kushtetues të akteve administrative, diçka që nuk përcaktohet në rastin italian dhe gjerman. Nuk ka asnjë dyshim që e njëjta vlen edhe për Spanjën dhe Francën: **amparo** spanjolle paraqet një kompetencë e veçantë që dominon pjesën dërrmuese të punës së **Tribunalit Kushtetues të Spanjës** (TKSp) ; kontrolli gjysmë-këshillëdhënës i **Këshillit Kushtetues të Francës** (KKFr) në çështjet e zgjedhjeve nacionale dhe të zgjedhjeve për president, si dhe kompetenca e kontrollit preventiv të normave ligjore përbëjnë cilësitë e dallueshme të gjyqësisë kushtetuese franceze. Mund të citohen shembuj të panumërt këtu që vërtetojnë këtë që e thamë më sipër. Cf. më shumë në Ibid., fq. 28-38 & 128.

14 Ibid., fq. 19-25.

kushtetues të punës së organeve të tjera shtetërore. Kjo nuk mund të vije si rezultat i një praktike gjyqësore, siç ka ndodhë në **Britaninë e Madhe** (1602) apo **SHBA** (1803), por vetëm me një sanksionim të qartë me kushtetutë të këtij autorizimi, i cili më pastaj mund të zgjerohet nga praktika gjyqësore kushtetuese. Baza e këtij përcaktimi kushtetues duhet të jetë shumë e qartë dhe të përfshijë tri aspekte bazike: organizimin, funksionimin dhe vetë kompetencat konkrete të gjykatës nacionale kushtetuese. Këto tri aspekte presupozojnë ekzistimin e dispozitave të domosdoshme kushtetuese lidhur me garancionet për pavarësinë organizative, administrative dhe financiare të institucionit që kryen funksionet e gjyqësisë kushtetuese dhe që quhet gjykatë/ tribunal/këshill kushtetues, si dhe të dispozitave të tjera të qarta që kanë të bëjnë me pavarësinë e anëtarëve të këtij institucioni.

E kundërta me këtë që u tha më sipër, në sistemin amerikan dhe në përgjithësi në vendet e sistemit të së **drejtës së përgjithshme** (**common law**) nuk ekziston një pluralizëm juridiksionesh dhe, **mutatis mutandis**, nuk mund të jetë veçse një sistem **difuz** (**i decentralizuar**) i kontrollit të kushtetutshmërisë. Kjo nënkupton se një çështje kushtetuese nuk mund të lindë jashtë kontekstit të ekzistimit të një rasti apo mosmarrëveshjeje konkrete, e cilësdo natyrë qoftë (administrative, civile-ekonomike apo penale).[15]

Këto dy cilësi të përbashkëta, të përshkruara si më sipër, përkatësisht kontrolli abstrakt dhe ngjashmëria e madhe e kushteve të krijimit dhe punës së gjyqësisë kushtetuese të modelit **kelsenian/evropian** janë reflektuar në dispozitat e nenit 6 të aneksit I të **Planit Ahtisari.** Në vijim i kthehemi diskutimit lidhur me natyrën e këtyre dispozitave kushtetuese. Sikundër mund të shihet nga dy dispozitat e sipërcituara, **Plani Ahtisari** ka lansuar modelin klasik **kesenian/ evorpian** të gjyqësisë kushtetuese. Kjo është kështu për dy arsye: e para, Plani ka vënë në mënyrë të qartë si kompetencë parësore të gjykatës së ardhshme kushtetuese kosovare kontrollin abstrakt të normës, duke ia lënë kushtetutës po ashtu të ardhshme shtjellimin e modaliteteve të veçanta të kësaj kompetence bazë dhe definuese të gjyqësisë kushtetuese ndër ne; dhe, e dyta, Plani e ka vënë gjykatën e ardhshme kushtetuese jashtë juridiksionit të rregullt gjyqësor dhe administrativ. Juridiksioni i rregullt gjyqësor ngërthen në vete tri rende juridiksionale (administrativ, civil-ekonomik dhe penal), kurse ai administrativ përfshin juridiksionin për zgjidhjen dhe vendosjen e çështjeve administrative me efekt përfundimtar.[16] Juridiksioni administrativ ushtrohet nga ana e **Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës**, një organ gjysmë-gjyqësor me të gjitha prerogativat për të ndarë drejtësi me efekt përfundimtar në çështjet administrative që lidhen me punën dhe marrëdhënien e punës.[17] Në sferën e vendimmarrjes administrative dhe të kontrollit të ligjshmërisë së akteve administrative, në tërësi vlejnë rregullat e juridiksionit të rregullt gjyqësor. Kjo sepse kontrolli i ligjshmërisë së akteve administrative i nënshtrohet rrugës së rregullt gjyqësore deri në **Gjykatën Supreme të Kosovës:** në nivel të Kosovës ekziston vetëm një **departament administrativ**, i cili funksionon në kuadër të **Gjykatës Themelore të Prishtinës.** Ky departament është kompetent për të gjykuar dhe zgjidhur në shkallë të parë të gjitha çështjet administrative që paraprakisht i kanë kaluar të gjitha procedurat administrative.

Kjo nënkupton se, për të ardhur në Gjykatë Kushtetuese sipas nenit 113.7 ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] i Kushtetutës, palët duhet që më parë t'i kenë shteruar të gjitha mjetet ju-

---

15 Ibid., fq. 12-14

16 Aneksi i parë i **Planit Ahtisari** titullohet si **Dispozitat Kushtetuese**, kurse neni i gjashtë i këtij aneksi titullohet si **Gjykata Kushtetuese dhe Sistemi i Drejtësisë.** Nga kjo shihet qartë se draftuesit e tij kanë bërë dallimin **kelsenian/evropian në mes të juridiksionit që do të ushtrohet nga gjykata e ardhshme kushtetuese e Kosovës** dhe juridiskioneve tjera gjyqësore dhe administrative. Këto të fundit kanë natyrë juridiko-administrative dhe ushtrohen nga një këshill i pavarur mbikëqyrës, siç është parashikohej në nenin 5.3 ["Qeveria e Kosovës"] të **Planit Ahtisari.**

17 Neni 101.1 [Shërbimi Civil] i Kushtetutës:
"[…] 2. Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës".

ridike. Kjo i bie që vendimet e **Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës** i nënshtrohen kontrollit kushtetues sepse janë vendime të fundit në procedurë administrative, gjithnjë flasim për vendimet përfundimtare të dhëna në sferën e marrëdhënieve të punës së shërbyesve civil në Kosovë.[18] Sa i përket vendimeve në çështjet tjera administrative, siç janë vendimet e Qeverisë dhe ministrive përkatëse, komunave dhe kështu me radhë, atëherë vlejnë rregullat e shterjes së mjeteve juridike, me fillim që nga ankesa në **Gjykatën Themelore të Prishtinës** – **Departamenti Administrativ** e deri te **Gjykata Supreme e Kosovës**. Pa shterjen e tyre nuk mund të vihet në lëvizje **Gjykata Kushtetuese** dhe, nëse vihet, me shumë siguri mund të thuhet se një rast të tillë, ajo do ta shpallë si të papranueshme për shkak të mosrespektimit të rregullit të shterjes së mjeteve juridike nga apeli e deri në **Gjykatën Supreme të Kosovës**. Këto procedura janë procedura të zakonshme të kontrollit të ligjshmërisë së akteve individuale administrative. Në këtë kuptim duhet kuptuar fjalinë nga neni 113.7 që thotë se kontrollit kushtetues i nënshtrohen të gjitha **shkeljet nga autoritetet publike** të të drejtave dhe lirive individuale.[19]

Sa i përket **sistemit të qeverisjes**, si cilësi e dytë që lidhet me lindjen dhe ekzistimin e gjyqësisë kushtetuese **kelseniane/evropiane**, **Plani Ahtisari** po ashtu plotëson kushtin e shtjelluar si më sipër me të cilin arsyetohet ekzistenca e gjyqësisë kushtetuese kosovare. Nenet 3, 4 & 5 të **Planit Ahtisari**, të cilat në mënyrë respektive kanë folur për Kuvendin, Kryetarin dhe Qeverinë, nuk lënë asnjë dyshim për natyrën parlamentare të sistemit qeverisës kosovar. Kjo rrjedh jo aq shumë nga përmbajtja e dispozitave të këtyre neneve sa nga dy faktorë të tjerë relevant: i pari ka të bëjë me definimin që neni 4 i bën rolit dhe pozitës së të **Kryetarit të Kosovës** në sistemin e ardhshëm kushtetues, kurse i dyti lidhet me faktin së në këto dispozita qartë aludohet për ruajtjen dhe vazhdimin e sistemit parlamentar të qeverisjes që ka funksionuar atëbotë sipas **Kornizës Kushtetuese**, u mor vesh tani në kushtet e një **Kosove** të pavarur dhe sovrane. Thënë me fjalë të tjera, këto katër nene e marrin si të mirëqenë vazhdimin e ekzistimit të sistemit parlamentar të qeverisjes së instaluar në **Kosovë** që nga viti 2001, vit në të cilin u nxor **Korniza Kushtetuese**. Se kjo është kështu shihet qartë nga dispozitat e Kushtetutës së vitit 2008 që definojnë qartë sistemin qeverisës në Kosovë. Këtu i theksuam këta dy faktorë sepse pjesa dërrmuese e dispozitave të neneve si më sipër të Planit fokusohen në ruajtjen e barazisë etnike në Kosovë, pa definuar sistemin qeverisës në mënyrë të qartë, me siguri duke u nisur nga supozimi se një gjë e tillë do të nënkuptohet meqë atëbotë në **Kosovë** ka funksionuar për vite të tëra një sistem i tillë qeverisës. Këto çështje, megjithatë, tejkalojnë caqet e diskutimit tonë në këtë libër. Tani i kthehemi temës sonë, e cila ka të bëjë me autoritetin emërues të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, gjithnjë sipas dispozitave të **Planit Ahtisari**.

---

[18] Në jursiprudencën e **Gjykatës Kushtetuese** ekzistojnë një grup lëndësh të vendosura, që njihen me emrin rastet e **Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës**. Cf. *Rasti KI 47/12. Aktgjykim. Parashtrues: Islam Thaci. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme Rev. Nr. 188/2009, të 7 dhjetorit 2011*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr.ref.: AGJ / 278/12. Prishtinë, më 16 korrik 2012; *Rasti KI 50/12. Aktgjykim. Parashtruesi Agush Lolluni. Vlerësim i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 153/2011, të 4 tetorit 2011, dhe Vendimit Nr. 02 (207) 2010, të 4 tetorit 2010, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës nga komuna e Junikut*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.: AGJ/279/12. Prishtinë, më 16 korrik 2012; *Rasti KI 55/11. Aktgjykim. Parashtrues: Fatmir Pireci. Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 518/2010, të 26 nëntorit 2010.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Nr. ref.: RK/277/12. Prishtinë, më 16 korrik 2012; *Rasti KI 129/11. Aktgjykim. Parashtrues: Viktor Marku. Vlerësim i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. Dr. 158/2011 të 5 korrikut 2011 dhe vendimit nr. 02/197/2010 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës nga ana e Komunës së Klinës*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Nr. ref.: AGJ/282/12. Prishtinë, më 17 korrik 2012; *Rasti KI 04/12. Aktgjykim. Parashtrues: Esat Kelmendi. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 647/2011, të 30 nëntorit 2011.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. Ref.: AGJ 285/12. Prishtinë, më 20 korrik 2012.
Në këto raste Gjykata ka treguar pa dykuptimësi se vendimet përfundimtare të dhëna nga ky organ kanë formën e prerë dhe për marrjen e tyre vlejnë standardet dhe rregullat për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, ashtu siç vlejnë për gjykatat e rregullta të **Kosovës**. Moszbatimi i vendimeve të **Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës**, sipas Gjykatës, përbën cenim të të drejtave kushtetuese. Ato vendime mund të ankimohen me **ankesë kushtetuese** në afatin kohor brenda katër muajve prej ditës kur pala ka marrë një vendim të tillë të Këshillit. Ky ankimim bëhet me qëllim të vënies së tyre në jetë për të realizuar një të drejtë kushtetuese, të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, cenimi i së cilës ka pasur për pasojë mohimin e të drejtës për punë.

[19] Për mendim të kundërt si dhe për moskuptim të këtij mekanizimi kushtetues kosovar, ku nuk ekziston një gjykatë administrative e specializuar, por një departament administrativ në kuadër të gjykatës së rregullte, **Gjykatës Themelore në Prishtinë**, Cf. më shumë në Joseph Marko, "The New Kosovo Constitution in a Regional Comparative Perspective" *Review of Central and East European Law* Vol. 33 No. 4 (2008) fq. 437-450 - fë. 445-446.

Autoriteti emërues dhe kushtet për emërim, si të gjyqtarëve vendorë ashtu edhe të atyre ndërkombëtarë, kanë qenë objekt rregullimi i dispozitave të **Planit Ahtisari**. Qasja **kelseniane/evropiane** ka gjetur vend vetëm sa i përket zbatimit të një kushti, gjë që përcaktohej në nenin 6.1 të këtij dokumenti, i cili kërkonte që gjyqtarët e ardhshëm kushtetues të plotësonin kushtin thelbësor nga modeli **kelsenian/evropian**, përkatësisht që të gjithë gjyqtarët kushtetues, vendorë e ndërkombëtarë, duhej të ishin juristë me profesion.[20] Sa i përket autoritetit me mandat për caktimin e tyre, gjërat kanë qenë ndryshe: koncepti **gjykatë hibride** ka qenë në tërësi i panjohur për **Hans Kelsen** dhe në kundërshtim me vetë fizionominë **kelseniane/evropaine** të gjyqësisë kushtetuese, ashtu siç është kuptuar ky aktivitet shtetëror në kohën kur ka lindur. Për pasojë, caktimi i gjyqtarëve kushtetues nga një autoritet ndërkombëtar nuk i shkon këtij kuptimi fillestar **kelsenian/evropian**. Kjo për shkak se cilësia e parë e tij, kontrolli abstrakt i normave juridike të nxjerra nga organi përfaqësues, pikërisht bazohet në kontrollin kushtetues të vullnetit të këtij organi përfaqësues. Ky organ përfaqësues, sipas konceptit origjinal kelsenian, legjitimohet përmes votës së lirë popullore, pa marrë parasysh dallimet etnike, gjuhësore, fetare dhe të tjera që mund të ekzistojnë brenda popullsisë së një shteti. Në kontekst të lindjes së gjyqësisë kushtetuese, gjykatat kushtetuese kanë pasur për mision primar kontrollin kushtetues të normave abstrakte, në rend të parë kontrollin kushtetues të ligjeve si shprehje e vullnetit të shumicës. Qëllimi parësor i këtij kontrolli ka qenë dhe ngelet që ato norma abstrakte të vihen brenda parametrave kushtetuese, të cilët përshkruhen në dispozita kushtetuese si shprehje e një vullneti tjetër më madhor që cilësohet si pushtet konstituiv (**pouvoirs constituant**). Në kushtet e vendeve që ushtrimin e pushtetit konstituiv e bëjnë me mbështetje kolosale nga **faktorët ndërkombëtar**, nuk mund të bëhet fjalë për zbatim të një gjyqësie të mirëfilltë kushtetuese për shkak se përbërja e saj është hibride: gjyqtarët e huaj vendosin për vullnetin e organit përfaqësues që materializohet në ligje dhe akte të tjera të përgjithshme. Krejt kjo bëhet me qëllim që vullneti politik i shprehur përmes votës së lirë i shprehur në zgjedhje dhe përmes formave të tjera të deklarimit të drejtpërdrejtë të realizohet brenda parametrave kushtetues, ashtu siç janë definuar nga pushteti konstitutiv i formësuar në kushtet e një ndikimi kolosal të faktorit ndërkombëtar. Çdo normë abstrakte, ligj apo akt tjetër i përgjithshëm, duhet të vihet brenda parametrave kushtetues të shprehur në dokumentin themelor kushtetues, të skicuar dhe përpiluar nën mbikëqyrjen apo me mbështetjen kolosale të faktorit ndërkombëtar. Për pushtetin kushtetutëbërës, origjiner (**povoirs constituant originaire**) dhe derivativ (**pouvoir constituant derive**) kemi folur në kapitullin njëmbëdhjetë dhe do të flasim sërish edhe në kapitujt tjerë të këtij libri.

Dispozitat e **Plani Ahtisari**, përveç kushtin e të qenit jurist, kanë qenë të heshtura sa i përket kushteve të tjera materiale, të cilat gjyqtarët vendorë dhe ndërkombëtarë është dashur t'i plotësojnë për t'u bërë gjyqtarë kushtetues. Neni 6 si më sipër ka pasur vetëm një dispozitë që ka folur për gjyqtarët ndërkombëtarë, dispozitën e nenit 6.1.3, e cila tregonte identitetin e autoritetit emërues të tyre.[21] Në fakt, ai ka pasur një dispozitë të ngjashme edhe për gjyqtarët vendorë.[22] Saktësimi i kushteve të tjera materiale që është dashur t'i plotësojnë kandidatët për gjyqtarë, vendorët dhe ndërkombëtarët, bëhej me Kushtetutën e vitit 2008 dhe **Ligjit nr. 03/L-121**. Mënyra e kontrollimit të procedurave për vërtetim të plotësimit të kushteve materiale shpjegohen në seksionin në vijim. Këtu vlen të theksojmë se, në ndërkohë që për gjyqtarët vendorë fare lehtë mund të dihet nëse dhe deri në çfarë mase kandidatët i kanë plotësuar kushtet materiale shtesë për t'u bërë gjyqtarë në vitin tanimë të largët 2009, e njëjta gjë nuk mund të thuhet për ndërkombëtarët: kur u bë emërimi i tyre në qershor të vitit 2009, u kuptua vetëm identiteti i autoritetit

---

20 Neni 6.1 ["Gjykata Kushtetuese dhe Sistemi i Drejtësisë"] i **Planit Ahtisari**: "[…] Gjykata Kushtetuese do të përbëhet nga nëntë gjyqtarë, të cilët do të jenë juristë të shquar me karakterin më të lartë moral".

21 Neni 6.1.3. ["Gjykata Kushtetuese dhe Sistemi i Drejtësisë"] i **Planit Ahtisari**: "[…] Tre gjyqtarë ndërkombëtarë do të emërohen nga Kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut pas këshillimit me Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar".

22 Neni 6.1.1["Gjykata Kushtetuese dhe Sistemi i Drejtësisë"] i **Planit Ahtisari**: "[…] 6.1.1 Gjashtë (6) gjyqtarë do të emërohen nga Kryetari me propozim të Kuvendit. Nga gjashtë gjyqtarët e emëruar për mandatin e parë, pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, dy (2) gjyqtarë do të shërbejnë për një mandat trevjeçar pa mundësi të rizgjedhjes, dy (2) gjyqtarë do të shërbejnë për një periudhë gjashtëvjeçare pa mundësi të rizgjedhjes dhe dy (2) gjyqtarë do të shërbejnë për një periudhë nëntëvjeçare pa mundësi të rizgjedhjes. Më tutje, çdo gjyqtar i emëruar në Gjykatën Kushtetuese do të emërohet për një mandat nëntëvjeçar pa mundësi të rizgjedhjes. Gjyqtarët, mandati i të cilëve pritet të skadojë në fund të periudhës fillestare prej tre apo gjashtë vjetësh, do të zgjidhen me short nga Kryetari i Kosovës menjëherë pas emërimit të tyre".

emërues dhe asgjë më tepër.[23] Ai autoritet ka qenë i përcaktuar në nenin e sipërcekur 6.1.3 të **Planit Ahtisari** dhe është i ndryshëm nga autoriteti emërues i përcaktuar me Kushtetutën e vitit 2008. Kjo e fundit nuk e cakton si autoritet emërues kryetarin e **GJEDNJ**, por vetë **PCN**-në.[24]

Në kohën e zgjedhjes së tyre, **Kosova** ka pasur pavarësinë e mbikëqyrur dhe nuk ka vlejtur parimi i supremacisë (epërsinë) së Kushtetutës, por parimi i supremacisë (epërsisë) së **Planit Ahtisari**, interpretues përfundimtar të të cilit kanë qenë autoritetet ndërkombëtare, përkatësisht vetë **PCN.**[25] Ajo që këtu ka rëndësi të ritheksohet, është se qasja lidhur me autoritetin emërues të gjyqtarëve ndërkombëtarë, e përqafuar respektivisht nga Plani dhe Kushtetuta e vitit 2008, nuk përbën një standard apo kriter **kelesenian/evropian**: sipas **Hans Kelsen**, autoritet emëruese të gjyqtarëve kushtetues duhet të jenë autoritetet (organet) kushtetuese që kanë natyrë politike, siç është shefi i shtetit, organi përfaqësues dhe ligjvënës si dhe ekzekutivi i vendit, mundësisht së bashku dhe në mënyrë të koordinuar.[26] Kështu është në pjesën dërrmuese të vendeve të demokracive kushtetuese liberale: autoritetet (organet) kushtetuese që kanë natyrë politike si më sipër kanë autorizime për emërim të gjyqtarëve kushtetues, qoftë në mënyrë të ndarë apo në koordinim ndërmjet veti. Këtë do ta shohim në seksionin në vijim kur flasim për sistemet e caktimit të gjyqtarëve kushtetues. Kriteri **keslenian/evropain** si më sipër duhet kuptuar në kontekstin e kushtit themelor që kërkohen për caktim të një gjyqtari kushtetues në këtë model. Ai kusht është thuajse i përbashkët në të gjitha vendet që kultivojnë modelin **keslenian/evropian**. Si i tillë ka të bëjë, sikundër e pamë më sipër, me të qenit **jurist**: për dallim nga gjyqtarët e karrierës, nga gjyqtarët kushtetues nuk kërkohet që domosdo të vijnë nga gjyqësori i rregullt, përkatësisht nuk kërkohet që ata të jenë gjyqtarë të karrierës dhe të kenë të kryer provimin e jurisprudencës apo ndonjë kualifikim tjetër shtesë. Në vendet ku ekzistojnë kuotat për gjyqtarë të rregullt, me kushtetutë përcaktohet qartë se sa gjyqtarë kushtetues duhet të vijnë nga gjyqësori i rregullt. Emërimi i tyre, megjithatë, nuk bëhet sipas procedurës së njëjtë që zbatohet për gjyqtarët e karrierës. I tillë është rasti, ta zëmë, me **Bullgarinë**, **Italinë**, **Portugalinë** dhe vendet tjera që i takojnë modelit të **caktimit të drejtpërdrejtë**.[27]

Kushtetuta e vitit 2008 dhe **Ligji nr. 03/L-121**, pas mbarimit të pavarësisë së mbikëqyrur në shtator të vitit 2012, kanë pësuar një transformim sa i përket mënyrës së caktimit të gjyqtarëve ndërkombëtarë, përkatësisht vazhdimit të mandatit të tyre të filluar në vitin 2009. Narrativi ynë në këtë seksion deri këtu, siç mund të shihet, gati në mënyrë ekskluzive ka pasur të bëjë me gjyqtarët ndërkombëtarë dhe mënyrën e caktimit të tyre gjatë kohës së pavarësisë së mbikëqyrur (2009-2012). Këtu e tutje duhet të sqarojmë mënyrën e caktimit të tyre pas mbarimit të pavarësisë së mbikëqyrur deri në vazhdimin e fundit të mandatit të tyre edhe për dy vite shtesë, vazhdim që ka ndodhur në qershor të vitit 2016. Ka rëndësi që lexuesi ynë të shohë teknikat juridike të këtij caktimi si dhe degjenerimin e tërësishëm të procesit të

---

23 Cf. fusnota nr. 8, **supra**, në këtë seksion, si dhe komentet lidhur me te.

24 Cf. fusnotat nr. 10 & 11, **supra**, në këtë seksion, si dhe teksti që i shoqëron.

25 Neni 11 ["Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar"] i **Planit Ahtisari**:
"11.1. Një Grup Drejtues Ndërkombëtar (**GND**), i cili do të përbëhet nga akterët kyç ndërkombëtarë, do të emërojë Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar (**PCN**) dhe do të kërkojnë nga **Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara** miratimin e emërimit. **PCN** dhe Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian (**PSBE**), i emëruar nga **Këshilli i Bashkimit Evropian**, do të jenë i njëjti person […]
11.3. **PCN** do të ketë përgjegjësi të përgjithshme për mbikëqyrjen, dhe do të jetë autoriteti përfundimtar në Kosovë për sa i përket interpretimit të kësaj Marrëveshjeje, siç parashihet me Aneksin IX, e veçanërisht nenin 2, të kësaj Marrëveshjeje".

26 Hans Kelsen, "La garantie juridictionnelle de la Constitution (La Justice constitutionnelle)" *Revue du Droit Public et de la Science Politique en France et à l'Étranger* (avril-mai-juin 1928), fq. 197-257 në fq. 226-227 (ku **Hans Kelsen** tregon se nuk duhet lënë që numri i anëtarve të jetë shumë i madh meqë gjyqtarët kanë për të dhënë përgjigje në pyetje krejt tekniko-juridike dhe të profesionit të ngushtë juridik-kushtetues; ata nuk duhet të zgjedhen thjeshtë vetëm nga parlamenti, nga shefi i shtetit apo nga qeveria; duhet insistuar në kombinimin e metodës së zgjedhjes përmes kooperimit të këtyre tri organeve shtetërore; ai shkon më tej, duke thënë se, përveç kësaj metode të zgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues, mund të parashikohet mundësia e njohjes së drejtës që vetë gjykata kushtetuese të zgjedh, përkataësisht të **kooptoj** anëtarët e vet për vendet vakante; kjo rekomandohet të bëhet ashtu që fakultetet juridike apo një komision i përbashkët i formuar nga të gjitha fakultetet juridike të bëjnë prezantimin (ofertimin) e kandidatëve të vet më të mirë për gjyqtarë kushtetues ashtu që vetë gjykata më pastaj nga mesi i tyre të përzgjedh kandidatët më të mirë me qëllim të **kooptimit** në gjirin e saj).

27 Cf. fusnotën nr. 81, **infra,** si dhe komentet tona lidhur me te.

caktimit të gjyqtarëve ndërkombëtar si pasojë e veprimit të papërgjegjshëm dhe joprofesional të njërit prej gjyqtarëve ndërkombëtarë, gjyqtarit **Robert Carolan**, para dhe pas fitimit të kontratës së tij të dytë më datën 1 tetor 2014, kontratë që i ka siguruar një rrogë të majme, shumëfish më të madhe se rroga e dy gjyqtarëve të tjerë ndërkombëtarë. Rroga e këtij gjyqtari, deri në dorëheqjen e tij të fundit dhe reale në shtator të vitit 2016,[28] ka qenë e përbërë nga tri burime: një pjesë e saj, deri në nivelin e rrogës së gjyqtarëve kushtetues vendor, është siguruar nga buxheti i varfër i **Kosovës**, pjesa e dytë e shumës mbi këtë rrogë të gjyqtarëve vendorë ka qenë e plotësuar nga buxheti i misionit **EULEX**, gjyqtar i të cilit ka qenë ky dhe dy kolegët e tij ndërkombëtarë dhe, në fund, pjesa e tretë është paguar nga vendi i tij i origjinës, **SHBA**-të. Kjo e fundit, në fakt, ka qenë pjesa kryesore dhe më e rëndësishme për shkak të së cilës kishte dhënë dorëheqje fiktive në shtator të vitit 2014, me qëllim shantazhi për t'ia rritur vetes rrogën mbi nivelin e dy gjyqtarëve të tjerë ndërkombëtarë.

Sa i përket gjyqtarëve vendorë, në **Kosovë** në tërësi vlejnë dispozitat e Kushtetutës së vitit 2008 dhe të **Ligjit nr. 03/L-121** që normojnë zgjedhjen, statusin dhe mandatin e gjyqtarëve kushtetues. Kjo ka qenë kësisoj që nga dita e parë e hyrjes në fuqi të Kushtetutës së vitit 2008 dhe të **Ligjit nr. 03/L-121.** Ky fakt, që e bënte të dallueshëm zgjedhjen, statusin dhe mandatin e gjyqtarëve kushtetues vendorë me kolegët e tyre ndërkombëtarë, na imponon që edhe diskutimin në këtë libër ta vazhdojmë ndaras për dy llojet e gjyqtarëve kushtetues: në ndërkohë që ky seksion më shumë flet për gjyqtarët ndërkombëtarë dhe zgjedhjen e tyre, seksioni në vijim sqaron në detaje procedurat e zgjedhjes së gjyqtarëve vendor. Në seksionet në vijim, statusi dhe mandati i vendorëve, i ndryshëm në secilin aspekt nga statusi dhe mandati i gjyqtarëve ndërkombëtar, trajtohet në mënyrë komparative dhe të njëkohshme me statusin dhe mandatin e gjyqtarve ndërkombëtar. Këtë dallim si më sipër në mes të gjyqtarëve vendorë dhe ndërkombëtarë, në tërësi i bazuar në **Planin Ahtisari** dhe në Kushtetutën e vitit 2008, e ka konstatuar edhe vetë Gjykata Kushtetuese në një vendim të vetin në rastin e njohur si **dekreti i parë i Presidentes Jahjaga për vazhdimin e mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë**, përkatësisht në rastin **KO 155/14.**[29] Rreshtat në vijim i kushtohen analizimit profesional të këtij rasti dhe pasojave të tij. Këtë e bëjmë për tri arsye. E para, sepse ka një rëndësi të jashtëzakonshme që lexuesi ynë t'i njohë specifikat për caktimin e gjyqtarëve kushtetues ndërkombëtarë në Kosovë, si dhe abuzimet që kanë ndodhur nga njëri prej tre gjyqtarëve ndërkombëtarë, gjyqtari **Rober Carolan**, pikërisht duke abuzuar me procedurat komplekse dhe të sofistikuara për caktimin e gjyqtarëve ndërkombëtarë që kanë vlejtur në atë kohë. Ky abuzim, sikundër u elaborua më lart, është bërë për motive babëzie të natyrës së përfitimit personal financiar. E dyta, në vijim të kësaj, sepse pa u bërë një vit ky rast do të jetë objekt i një aktakuze skandaloze kundër autorit të parë të këtij libri, gjë të cilën e përshkruajmë tek seksioni që flet për imunitetin e gjyqtarëve kushtetues në përgjithësi dhe dallimin në mes të imunitetit të gjyqtarëve vendorë dhe gjyqtarëve ndërkombëtarë, gjithnjë nga aspekti komparativ. Dhe, e treta, sepse organi kontrollues kompetent anti-korrupsion dhe anti-mashtrim në kuadër të **BE**-së, i njohur si **OLAF**, kishte konstatuar abuzimet e këtyre procedurave juridike për emërim me qëllim të realizimit të përfitimeve personale nga gjyqtari ndërkombëtar në fjalë.[30] **Në vijim pason diskutimi** i teknikave të përdoruara për emërim të gjyqtarëve kushtetues ndërkombëtarë pas mbarimit të pavarësisë së mbikëqyrur në shtator të vitit 2012.

---

28 Për historikun e dorëheqjes së tij të parë dhe fiktive për qëllime të përfitimit personal, përkatësisht me qëllim të fitimit të kontratës së dytë dhe fitimit të një rrogë të majme, cf. fusnotën nr. 19 në kapitullin **11** dhe fusnotën nr. **77** në këtë kapitull, si dhe tekstin që shoqëron komentet tona në dy fusnotat.

29 *Rasti KO 155/14. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Dekretit të Presidentes së Republikës së Kosoves për konfirmimin e vazhdimit të mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. DKGJK-001-2014, të 31gushtit 2014.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.: RK732/14. Prishtinë: më 13 nëntor 2014. Në paragrafin 44 të këtij aktvendimi thuhet si vijon: "[…] 44. Perveç kesaj, Gjykata rikujton se për emërimin e gjyqtarëve ndërkombetarë ishte ndjekur nje procedurë tjetër dhe ishin aplikuar kërkesa të tjera nga ato për emërimin e gjyqtarëve kosovarë. Mandati i gjyqtareve nderkombëtarë dallon gjithashtu dhe është i përcaktuar me kontratë të ofruar nga aktorë ndërkombëtarë".

30 Cf. fusnota nr. 19 në **Kapitullin 11** si dhe fusnotat nr. 80 & 206 në këtë kapitull, si dhe tekstin që i shoqëron.

Amendamenti i sipërcekur kushtetutës nr. **22**,[31] ka kaluar kontrollin kushtetues (preventiv) të Gjykatës Kushtetuese.[32] Si i tillë, ai ka qenë pjesë e amendamenteve kushtetuese me të cilat është mbyllur pavarësia e mbikëqyrur e **Kosovës**.[33] Ai ka ndërtuar një bazë të re kushtetuese të përkohshme për vazhdimin e mandatit të tre gjyqtarëve kushtetues ndërkombëtarë. Këta gjyqtarë janë emëruar për herë të parë të **PCN**, bazuar në dispozitat tanimë të shtjelluara të **Planit Ahtisari**.[34] Kjo bazë kushtetuese, siç vërehet nga formulimi i amendamentit të sipërcekur, ka qenë e njëjtë për të gjithë personelin e misionit **EULEX** nëpër gjykata të rregullta, prokurori, autoritete dhe organe të tjera kushtetuese dhe agjensione të pavarura në të cilat kanë qenë të atashuar për të punuar (të tilla kanë qenë, ta zëmë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Agjensioni i Pronës i Kosovës, Agjensioni i Privatizimit i Kosovës etj). Në këtë kuadër hyn edhe emërimi i gjyqtarëve ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese, si dhe i këshilltarëve ndërkombëtarë ligjorë: të gjithë janë emëruar me vendime të veçanta individuale nga ana e **PCN**, në vijim të implementimit të bazës së re kushtetuese të ndërtuar me amendamentin e sipërcekur nr. **22**. Ky amendament, sikundër u pa më sipër, përcaktonte se do t'u vazhdohej mandati atyre të cilëve ende nuk u kishte skaduar ai i dhënë më parë nga ana e **PCN**.[35] Për të qenë brenda kushteve të parashikuara me amendamentin nr. **22** si më sipër, **PCN** kishte bërë emërimin e gjyqtarëve ndërkombëtarë në Gjykatë para hyrjes në fuqi të këtij amendamenti,[36] njëjtë siç kishte bërë me stafin tjetër. Këta të emëruar, si në **Gjykatën Kushtetuese** ashtu dhe në organet dhe agjensionet tjera shtetërore (gjyqësi e rregullt, prokurori shtetërore, agjensione të pavarura dhe organe tjera shtetërore) kanë pasur statusin e stafit të **EULEX**-it, me imunitete dhe privilegje diplomatike përkatëse në mënyrën e përcaktuar me Konventën e Vjenës për Marrëdhënie Diplomatike (**KVMD**). Kësaj çështjeje i kthehemi sërish në seksionin mbi imunitetet. E njëjta vlen edhe për këshilltarët ligjorë që kanë operuar në **Gjykatën Kushtetuese**, gjyqësorin e rregullt, prokurori shtetërore, agjensione të pavarura dhe organe të tjera shtetërore kosovare.[37] Kjo bazë kushtetuese për vazhdim, po ashtu nuk përbën një standard **kelsenian/evropian** në kuptimin klasik të kësaj fjale, për aq sa kjo ka të bëjë me autoritetin caktues dhe mënyrën e zgjatjes (vazhdimit) së mandatit të gjyqtarëve kushtetues. Në këtë drejtim, siç u pa, **Kosova** nuk është vetëm dhe paraqet shtetin e tretë evropian që ka një model të tillë të caktimit të gjyqtarëve kushtetues.

Amendamenti kushtetues nr. **22**, si bazë kushtetuese për vazhdim të mandatit (rimandatim) të gjyqtarëve kushtetues ka pasur natyrë të vetekzekutueshme. Kjo do të thotë se për vënien e tij në jetë dhe, për pasojë,

---

31 Cf. fusnota nr. 12 në këtë seksion, **supra**, si dhe teksti që e shoqëron.

32 *Arasti KO 38/12. Aktgjykim. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Propozimeve të Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës, të dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës më 12 prill 2012*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Nr. ref.:AK 234 /12. Prishtinë, më 15 maj 2012.

33 Cf. **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**. **Aneks: Amendamentet I – XXII Amendamentimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare te pavarësisë së Kosovës**.. *Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04- V- 436 të datës 7 shtator 2012. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* nr. 25 datë 7 shtator 2012

34 Sikundër është thënë më herët (cf.fusnota nr. 8, në këtë seksion, **supra**, si dhe komentet tona që e shoqërojnë), mënyra e caktimit të tyre dhe kriteret që ata i kanë plotësuar, pos të qenit jurist, ngelen sot e kësaj dite një mister. Kjo për shkak se procesi i caktimit të tyre në **Gjykatën Kushtetuese** asnjëherë nuk ka qenë transparent (është kryer jashtë syrit të publikut kosovar); Për komentet rreth personalitetit të këtyre gjyqtarëve, cf. më shumë në librin e njërit ndër zyrtarëve të lartë ndërkombëtar të kohës që kanë punuar në Kosovë: Andrea Lorenco Capussela, *State – Building in Kosovo. Democracy, Corrpution and the EU in the Balkans*, fq.164-165, 174,176 (autori me tone jashtëzakonisht negative flet për gjyqtarët ndërkombëtar, në veçanti për gjyqtarin **Robert Carolan**, të cilin e paraqet si të politizuar, të anëshëm dhe joprofesional; për gjyqtarët vendorë thotë se kanë qenë të rebeluar dhe kanë ndjekur sentimentin popullor mesatar me rastin e vendimmarrjes në rastet që kanë qenë të ndieshme për opinionin publik vendor, duke marrë si shembull rastin e rrëzimit nga **Gjykata Kushtetuese** të **Behxhet Pacolli**-t nga posti i **Presidentit të Kosovës**).

35 Cf. fusnotën nr. 12, **supra,** si dhe sqarimet e dhëna lidhur me këtë në tekstin **supra.**

36 Me 17 korrik 2012, **PCN** nxori Vendimin Nr. 2012/17, Vendimin Nr. 2012/18 dhe Vendimin Nr. 2012/19, për riemërimin e gjyqtarëve ndërkombëtarë deri më 31 gusht 2014. Vendimet gjenden në **Arkivën e Gjykatës Kushtetuese**.

37 Si këshilltarë ligjor ndërkombëtar në Gjykatë, që nga vitet e saj formative, kanë shëbryer zz. **Johan Van Lemon** (Hollandë) nga shtatori 2009 deri më nëntor të vitiit 2016, **Ron Hogimestra** (Hollandë), nga shtatori 2009 deri në qershor 2018, **Michael Bourke** (Irlandë) nga janari 2010 deri në shtator të vitit 2012 dhe **Dzenana Hadjiomerovic** (Bosnje-Hercvegovinë) nga nëntori 2009 deir në qershor 2015. Të dhënat për këtë, kontratat e tyre të punës, nga një kpje, gjenden në arkivën e **Gjykatës Kushtetuese;** Për tekstin e plotë të **KVMD**, cf. *Vienna Convention on Diplomatic Relations* (1961). Në internet: http://legal.un.org /ilc/texts/instruments/english/co n ventions/9_1_1961.pdf (shikuar në prill 2018).

vazhdimin e mandatit të gjyqtarëve kushtetues (rimandatimin) e ri të gjyqtarëve, nuk kërkohej një akt tjetër implementues për vënien në jetë të këtij amendamenti: akti i rimandatimit është nxjerrë nga ana e **PCN** në korrik të vitit 2012, kur janë nxjerrë vendimet për riemërim të tyre për dy vitet në vijim, pra deri më datën 31 gusht të vitit 2014.[38] Me këtë është anashkaluar roli i Kuvendit dhe i **Presidentit të Kosovës** në procedurat e emërimit të gjyqtarëve kushtetues. Ky anashkalim ka qenë në tërësi kushtetues dhe ligjor sepse është kryer në harmoni me **Planin Ahtisari** dhe konceptin e pavarësisë së mbikëqyrur, të cilët kanë qenë në fuqi deri në shtator të vitit 2012. Mandati i gjyqtarëve ndërkombëtarë në vitet 2014-2016 dhe 2016-2018 është vazhduar përmes lidhjes së dy marrëveshjeve të reja dhe të veçanta ndërkombëtare në mes të **Kosovës** dhe autoriteteve evropiane, duke përdorur teknikën juridike të **letërkëmbimit.** Esenca e vazhdimit për dy periudhat ka qenë që të anashkalohet njëri prej organeve shtetërore në procesin e rimandatimit të gjyqtarëve ndërkombëtarë. Organi që anashkalohej me dy marrëveshjet e reja ndërkombëtare të lidhura përmes letërkëmbimit në mes të **Kosovës** dhe **BE**-së ka qenë Kuvendi, i cili në rrethanat normale paraqitet si propozues i gjyqtarëve kushtetuese. Këtë propozim, ai e bën përmes votimit me qëllim zgjedhjen e gjyqtarëve të ri kushtetues. Më pastaj, këta gjyqtarë shkojnë për dekretim dhe betim te Presidenti i Republikës. Kjo procedurë nuk është ndjekur me rastin e rimandatimit të gjyqtarëve kushtetuese ndërkombëtar ne vitet 2014-2016 dhe 2016 – 2018. Në këtë rast ka ardhur deri te mënjanimi i Kuvendit si propozues (përmes votimit me qëllim zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetues), ashtu që ata kanë pasur nevojë te presin vetëm Presidentin për dekretimin formal të këtij rimandatimi. Ky anashkalim bëhej në tërësi sipas dispozitave të Kushtetutës së vitit 2008 që lejojnë bartjen e sovranitetit në një organizatë ndërkombëtare për çështje dhe lëmi të caktuara.[39]

Baza e re e sipërcekur juridiko-kushtetuese për vazhdimin e mandatit të gjyqtarëve kushtetues ndërkombëtarë, për herë të parë u krijua në vitin 2014.[40] Ajo u bë përmes një **letërkëmbimi** në mes të **Kosovës** dhe **Evropës**, pas skadimit të mandatit të gjyqtarëve dhe këshilltarëve ndërkombëtarë, të emëruar nga **PCN**-ja, përkatësisht nga **Piter Fajt**, në korrik të vitit 2012.[41] Marrëveshja e re e lidhur përmes letërkëmbimit paraqet një akt juridik ndërkombëtar që ka zëvendësuar amendamentin e sipërcekur kushtetues nr. **22**. Për dallim nga ky i fundit, marrëveshja nuk ka pasur dispozita të vetekzekutueshme: ajo ka shërbyer vetëm si bazë juridike për rimandatim të ri, duke krijuar kësisoj një detyrim të ri ndërkombëtar për Kosovën. Vënia në jetë apo aktivizimi i dispozitave të saj, ndërkaq, nuk ka mundur të ndodhë në mënyrë automatike. Për të ndodhur një gjë e tillë është dashur të vijë deri te nxjerrja e një akti tjetër individual nga ana e një autoriteti kosovar, ashtu siç përcaktohej me vetë tekstin e marrëveshjes në fjalë, e cila, si u tha, ishte lidhur përmes teknikës juridike të **letërkëmbimit.** Ka raste kur akti implementues i një detyrimi ndërkombëtarë ka natyrë të aktit të përgjithshëm, siç është, ta zëmë, nxjerrja e një amendamenti kushtetues, ligji etj.

Të shohim në vijim si është realizuar (implementuar) kjo marrëveshje, përkatësisht përmes cilës teknikë të brendshme juridiko-kushtetuese është vënë në jetë marrëveshja ndërkombëtare për rimandatim të gjyqtarëve kushtetues ndërkombëtarë. Sikundër u tha, kanë ekzistuar dy marrëveshje që janë lidhur përmes teknikës juridike të **letërkëmbimit**: marrëveshja e parë që ka mbuluar periudhën prej vitit 2014 deri në vitin 2016, dhe periudha e dytë që përfshin dy vitet në vijim, 2016-2018.

---

38 Cf. fusnotën nr. 42, **infra**, në këtë kapitull, si dhe komentet tona aty.

39 Neni 20.1 [Bartja e Sovranitetit] i Kushtetutës: "1. Republika e Kosovës, në bazë të marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare, për çështje të caktuara mund të kalojë kompetenca shtetërore organizatave ndërkombëtare".

40 "Letra e Presidentes **Atifete Jahjaga** nr. 346 e datës 14 prill 2014, Prishtinë". **Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës.** Ky letërkëmbim si instrument juridik me të cilin është arritur marrëveshja në mes të palëve përbën pjesë përbërse të ligjit me të cilin është bërë ratifikimi, për të cilin diskutojmë në vijim.

41 Funksionin e **PCN** e ka mbajtur zt. **Piter Fajt** (**Pieter Feith**), nga fillimi deri në fund, përkatësisht nga viti 2008 deri më 7 shtator 2012. Në periudhën prej 2008 deri në vititn 2011, zt. **Piter Fajt** ka luajtur edhe rolin e përfaqësuesit special të **BE**-së. Cf. Më shumë për pozitën dhe rolin e **PCN**-së dhe të përfaqësuesit special të **BE**-së në Kosovë në kohën sa ka qenë në fuqi **Plani Ahtisari** kemi folur më herët në seksionin e tretë të kapitullit 10 të këtij libri; Cf. po ashtu edhe Steven Hill & Paul Linden-Retek, "Supervised Independence and Post-Conflict Sovereignty", fq. 32-36.

Në gusht të vitit 2014, ka skaduar mandati i gjyqtarëve dhe këshilltarëve ndërkombëtarë. Nga mbarimi i pavarësisë së mbikëqyrur në shtator të viti 2012 më nuk kishte një **PCN** për të vepruar, kurse baza e krijuar me amendamentin kushtetues nr. **22** kishte humbur rëndësinë dhe kishte skaduar ditën që ishte mbyllur pavarësia e mbikëqyrur e Kosovës: më nuk ekzistonin rrethanat kalimtare të cilat normoheshin me atë amendament. Thënë me fjalë te tjera, ky amendament ka pasur vlerë kalimtare për të vërtetuar vetëm një herë riemërimin e gjyqtarëve kushtetues ndërkombëtarë, gjë që ishte kryer në korrik të vitit 2012 nga ana e **PCN**-së. E njëjta vlente edhe për personat tjerë që ishin caktuar nga **PCN** nëpër postet e ndryshme në gjyqësi, prokurori, agjensione dhe organe të tjera të **Republikës së Kosovës**. Ky vazhdim (rimandatim) vlente deri në korrik-shtator të vitit 2014, në vartësi të kohës së rimandatimit të tyre nga **PCN**-ja: gjyqtarët ndërkombëtarë kushtetues ishin rimandatuar në korrik të vitti 2012. Kjo u tha më herët. Tani duhej ndërtuar një bazë të re kushtetuese për rimandatim të tre gjyqtarëve ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese, të gjyqtarëve të tjerë të gjykatave të rregullta, të prokurorëve dhe personave të tjerë që ishin staf i **EULEX**-it.

Këtë radhë kjo bazë kushtetuese u krijua përmes ndjekjes së një teknike tjetër juridike, jo përmes miratimit **post-festum** të një amendamenti kushtetues që do të legalizonte (vërtetonte) një gjendje të krijuar nga një autoritet tjetër ndërkombëtar. Kjo bëhej për dy arsye: e para, sepse më nuk kishte një **PCN** apo autoritet tjetër të mandatuar ndërkombëtarisht për të kryer punët e sovranitetit të Kosovës; dhe, e dyta, tani Kosova kishte marrë në tërësi autorizimet e saj kushtetuese të një shteti sovran dhe të pavarur. Më nuk mund të bëhej fjalë për bartjen e të gjitha procedurave të mandatimit, por vetëm të asaj që kishte të bënte me propozuesin (Kuvendin e Kosovës apo organet e trupat tjerë vendorë që bënin propozimet për gjyqtarë, prokurorë dhe staf tjetër ndërkombëtar që punonte brenda organeve e institucioneve të Kosovës). Një hallkë në zinxhirin e mandatimit duhej lënë në duar të organeve vendore, përkatësisht të **Presidentit të Kosovës**, gjë që ishte në pajtim me sovranitetin dhe pavarësinë e plotë të vendit të rifituar pas shtatorit të vitit 2012. Për këto dy arsye, baza e re juridike duhej ndërtuar në mbështetje të së **drejtës ndërkombëtare kontraktuale**, gjithnjë duke u bazuar në dispozitat kushtetuese që normojnë aktivitetin ndërkombëtar të një shteti sovran dhe të pavarur. Jo vetëm Kushtetuta e vitit 2008, por të gjitha kushtetutat e vendeve moderne parashikojnë dispozita të tilla që normojnë aktivitetin ndërkombëtar të një shteti.

Në këtë kuptim, më datën 14 prill 2014, **Presidentja e Republikës se Kosovës**, **Atifete Jahjaga**, i dërgoi letër Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Baroneshës **Katerinë Ashton** (Cathrine Ashton), **inter alia**, për të konfirmuar *"emërimin* e [....] *gjyqtarëve ndërkombëtarë që shërbejnë në Gjykatën Kushtetuese dhe të emëruar nga PCN-ja [...]"*.[42] Nga aspekti i të drejtës ndërkombëtare, kjo letër përbën njërin prej formave të shprehjes së vullnetit të shtetit për të hyrë në një marrëveshje ndërkombëtare, pra një prej mënyrave që kanë për qëllim shprehjen e vullnetit të shtetit për të lidhur një marrëveshje ndërkombëtare në kuptim të nenit 11 të Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve (**KVDT).**[43] E përbashkëta e të gjitha instrumenteve të shkëmbimit

[42] Cf. fusnota nr. **38**, **supra**, në këtë seksion, si dhe komentet tona me te.

[43] Neni 11 ["Mënyrat e shprehjes së vullnetit për tu detyruar nga një traktat"] i **KVDT:** "Pëlqimi i një shteti për t'u detyruar nga dispozitat e një traktati mund të shprehet me nënshkrim, shkëmbim instrumentesh që përbëjnë traktat, ratifikim, pranim, aprovim apo aderim, ose nga çdo mjet tjeter nëse kështu është rënë dakord". Nuk ka asnjë dyshim që letërkëmbimi përbën instrumentin më të zakonshëm dhe standard në komunikimin ndërshtetoror. Cf. No. 18232 MULTILATERAL *Vienna Convention on the Law of Treaties* (With Annex). Concluded at Vienna on 23 May 1969. Authentic texts: English, French, Chinese, Russian and Spanish. Registered ex officio on 27 January 1980. Në internet: https://treaties.un.org/doc/publication/unts/volume%201155/volume-1155-i-18232-english.pdf (shikuar në mars 2018).
Letërkëmbimi bën pjesë në kuadër të teknikave juridike klasike të së drejtës ndërkombëtare, krahas tjerave nga neni 11 i **KVDT.** E drejta ndërkombëtare, megjithatë, është shumë fleksibile dhe i lejon shtetet dhe subjektet tjerë të së drejtës ndërkombëatre që vetë të përcaktojnë teknika tjera juridike. Në fakt, e drejta ndërkombëtare shumë pak interes tregon për formën sa i përket lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare duke u fokusuar në vullnetin dhe qëllimin e palëve. Kjo nënkupton se shtete dhe subjektët tjerë mund të përdorin metodat klasike, por vetë vendosin se cila ka qenë përmbajtja e tyre: ato janë autonome në këtë drejtim. Për më tepër, asnjë imponim **KVDT** nuk e bën sa i përketë përparësisë së teknikave juridike që mund t'i përdorin shtetet dhe subjektet tjerë të së drejtës ndërkombëtare. Oliver Dörr and Kirsten Schmalenbach (eds.), *Vienna Convention on the Law of Treaties. A Commentary*. Second Edition (Springer - Verlag GmbH: Germany, 2018), fq. 169-170 & 173; Mark E. Villiger, *Commentary on the 1969 Vienna Convention on the Law of Treaties* (Martinus Nijhoff Publishers: Leiden and Boston, 2009), fq. 177, 179.

me qëllim të shprehjes së vullnetit të shtetit për të lidhur një marrëveshje ndërkombëtare është se ato duhet të jenë të shprehura në formë të shkruar.[44]

Letërkëmbimi, si një nga teknikat e njohura klasike juridike për shprehjen e vullnetit të shtetit për të lidhur një marrëveshje ndërkombëtare, konsiderohet si një mënyrë më e shpejtë dhe më e lehtë e shprehjes së vullnetit të një shteti apo subjekti të së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Kjo teknikë e lehtë dhe e thjeshtë asnjëherë nuk nënkupton se marrëveshja e arritur përmes saj ia humb efektin legal një detyrimi (zotimi) të marrë në planin ndërkombëtar apo të një drejte të fituar ndërkombëtarisht.[45] Se cilat janë efektet juridike dhe caqet e marrëveshjes së lidhur përmes letërkëmbimit, në rast të dyshimit sa i përket efekteve dhe caqeve në fjalë, përcaktohet në mënyrë të njëjtë sikur me rastin e çdo marrëveshjeje ndërkombëtare: çdoherë merret parasysh objekti dhe qëllimi i marrëveshjes dhe cili ka qenë vullneti i vetë palëve.[46] Nuk ka rëndësi që **KVTD** nuk definon se çka nënkuptohet me objektin dhe qëllimin e marrëveshjeve. Në doktrinë dhe në komentarët e **KVDT** qartë përcaktohen **elementi objektiv** (natyra e çështjet, si dhe konteksti aktual dhe historik i arritjes së marrëveshjes) dhe **elementi subjektiv** (vullneti i palëve lidhur me qëllimin e marrëveshjes, intuita dhe sensi i zakonshëm) si definues të këtij koncepti **enigmatik**, siç e ka quajtur një autor. Është po ashtu me rëndësi të thuhet se objekti dhe qëllimi i marrëveshjes duhet të kuptohen në kombinim dhe jo në mënyrë të ndarë nga njëri-tjetri.[47] Kjo duhet të vlejë edhe për rastin konkret të marrëveshjes së lidhur në mes të **Kosovës** dhe **BE**-së.

Në këtë kontekst dhe shprehur në një mënyrë më të qartë, letra e parë si më sipër e **Presidentes Jahjaga** paraqet pjesë të një instrumenti juridik, i vlefshëm si në aspektin kushtetues ashtu dhe në aspektin e të drejtës ndërkombëtare, që ka shërbyer për shprehjen e vullnetit në emër të shtetit të Kosovës. Si i tillë, letërkëmbimi i parë është iniciuar nga pala kosovare, **Presidentja Jahjaga**, dhe ka pasur për objekt ndërtimin e bazës së re për rregullimin e vazhdimit të mandatit të tre gjyqtarëve ndërkombëtarë, me qëllim të rimandatimit të tyre për një periudhë tjetër shtesë dyvjeçare. Kjo është kështu sepse janë shtetet sovrane ato që vetë përcaktojnë se cilën teknikë juridike do ta zgjedhin me rastin e shprehjes së vullnetit të tyre për t'u detyruar përmes lidhjes së një marrëveshjeje ndërkombëtare.[48] Neni 11 i **KVDT** përcakton disa nga mënyrat apo teknikat juridike për shprehjen e këtij vullneti, ku bën pjesë edhe letërkëmbimi. Dispozitat e këtij neni, që flasin për shkëmbimin e instrumenteve si nga mënyrat për shprehjen e vullnetit shtetëror për lidhjen e një marrëveshje ndërkombëtare, në thelb janë dispozita që flasin për teknikat juridike të së drejtës zakonore ndërkombëtare mbi të drejtën e traktateve.[49] Këto teknika nuk janë

---

44 Si instrumente tjera mund të jenë **notat**, **notat verbale, telegramet, mesazhet, memorandumet, ad memoaret, korrespondenat** dhe **format tjera formale** për shprehjen dhe *përçimi*n e vullnetit të një subjekti të së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Oliver Dörr and Kirsten Schmalenbach (eds.), *Vienna Convention on the Law of Treaties*, fq. 193; Mark E. Villiger, *Commentary on the 1969 Vienna Convention on the Law of Treaties*, fq. 200

45 Mark E. Villiger, *Commentary on the 1969 Vienna Convention on the Law of Treaties*, fq. 198

46 Kjo nënkupton se këmbimi i **notave**, **notave verbale, telegrameve, mesazheve, memorandumeve, ad memoareve, korrespondencave** dhe **formave tjera të komunikimit** në mes të shteteve nuk përbën shprehje të vullnetit përmes këmbimit të këtyre instrumenteve. Për të pasur këtë vlerë, pra të synimit për të lidhur një marrëveshje, letërkëmbimi apo këmbimi i instrumenteve tjera (**notave, notave verbale, komunikatave, ad memoareve, korrespeondencave** dhe **formave tjera të komunikimit**), një gjë e tillë duhet të jetë në mënyrë shprehimore e shprehur nga ana e palëve. Kjo nënkupton se me rastin e lidhjes së marrëveshjeve përmes këmbimit të instrumenteve duhet të ketë vullnet reciprok për një gjë të tillë. Për këtë arsye në rastin e letërkëmbimeve, zakonisht vjen deri te ripërsëritja **ad literam** e asaj që ka thënë pala tjetër. Në rastin e teksteve të gjata, megjithatë, nuk ka nevojë të përsëritet teksti i palës së parë dhe anasjelltas. Kjo është kështu sepse janë palët ato që vetë në fund vendosin se në çfarë mënyre dhe vëllimi t'i krijojnë detyrimet ndërmjet veti, si dhe kohën e hyrjes së tyre në fuqi. Këtu hyn edhe vendosja e lirë e tyre sa i përket mënyrës dhe vëllimit të përsëritjes ose mospërsëritjes së asaj çfarë ka thënë pala tjetër në instrumentin praktik të këmbimit me qëllim të lidhjes së një marrëveshjeje. Çdoherë duhet të shikohet se cili ka qenë objekti dhe qëllimi i letërkëmbimit si dhe historia negociuese e letërkëmbimit, për të konstatuar sakët se cilat janë efektet juridike të letërkëmbimit që palët e kanë synuar dhe dëshiruar. Ka raste kur kuptimi i marrëveshjes së arritur përmes këmbimit të instrumenteve është nxjerrë nga kuptimi i tërësishëm i korrespendencës së këmbyer në mes të palëve, pra jo nga përsëritja **ad literam** e asaj që ka thënë pala tjetër. Cf. Oliver Dörr and Kirsten Schmalenbach (eds.), *Vienna Convention on the Law of Treaties*, fq. 193, 195-197; Mark E. Villiger, *Commentary on the 1969 Vienna Convention on the Law of Treaties*, fq. 199.

47 Christian Djeffal, "Commentaries on the Law of Treaties: A Review Essay Reflecting on the Genre of Commentaries". *The European Journal of International Law* Vol. 24 no. 4 (2013 fq. 1223–1238, *në fq. 1227-1229.*

48 Mark E. Villiger, *Commentary on the 1969 Vienna Convention on the Law of Treaties*, fq. 175

49 Oliver Dörr and Kirsten Schmalenbach (eds.), *Vienna Convention on the Law of Treaties*, fq. 169-170; Mark E. Villiger, *Commentary on the 1969 Vienna Convention on the Law of Treaties*, fq. 179, 2002.

të vetmet: e drejta ndërkombëtare nuk i kufizon shtetet dhe subjektet tjera të së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare me një teknikë të vetme dhe konkrete për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare. Kjo shihet nga formulimi i nenit 11, i cili ka një klauzolë në fund të fjalisë që thotë se ekzistojnë mënyra të tjera për të shprehur vullnetit shtetëror, përveç atyre që neni në fjalë i përmend në mënyrë shprehimore.[50]

Format e përmendura në nenin 11 të **KVDT** janë format formale për shprehjen e vullnetit dhe mund të kombinohen me format tjera jo formale, apo me format më pak formale: shtetet dhe subjektet tjera të së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare janë të lira që vetë të vendosin për njërën prej këtyre formave formale të shprehjes së vullnetit, si dhe për kombinimin e tyre me format tjera joformale apo më pak formale.[51] Marrëveshjet e lidhura përmes metodës së **letërkëmbimit**, zakonisht nuk i nënshtrohen ratifikimit kushtetues, përveç nëse palët vetë kanë përcaktuar një gjë të tillë në mënyrë shprehimore.[52]

Ky lloj i marrëveshjes që mëtohej të arrihej nga ana e palës kosovare përmes këmbimit të letrave me **BE**-në, bënë pjesë në prerogativat klasike të sovranitetit shtetëror të përcaktuar me Kushtetutë, të cilat mund të barten te një autoritet tjetër i jashtëm (organizatë ndërkombëtare).[53] Këtë herë bëhej fjalë për bartjen e një sfere të caktuar të pushtetit shtetëror, përkatësisht për **rimandatime të reja** të personave të caktuar në gjykatën kushtetuese, në gjyqësorin e rregullt, në prokurori dhe në agjensionet e caktuara të pavarura dhe në disa organe tjera shtetërore. Në fakt, propozimi i letrës së **Presidentes Jahjaga** bënte fjalë për riemërime, por në një numër më të reduktuar, të individëve që veç ishin duke punuar nëpër institucione, agjensi e organe shtetërore kosovare nga periudha paraprake e pavarësisë së mbikëqyrur.[54] Ky propozim u pranua ditën e njëjtë, pra më 14 prill 2014, me përgjigje pozitive të palës evropiane. Me këtë akt, **letërkëmbimi** plotësonte kushtin formal kushtetues dhe, sipas të drejtës ndërkombëtare, për të ndërtuar një obligim të ri ndërkombëtar për Kosovën.[55] Futja e saj në rendin juridik kosovar, megjithatë, duhej të realizohej domosdo përmes procedurës së ratifikimit të këtij instrumenti nga ana e përfaqësuesit të sovranit, **Kuvendit të Kosovës.** Kjo duhej bërë sepse **letërkëmbimi** ka natyrën juridike të një marrëveshje ndërkombëtare.[56] Kjo u realizua më datën 23 prill 2014, me miratimin e "Ligjit nr. 04/L-274 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë" (**Ligji nr. 04/L-274**).[57]

Kjo marrëveshje zëvendësoi rolin dhe funksionin që kishte pasur **PCN** sipas **Planit Ahtisari** dhe amendamentit kushtetues nr. **22** të datës 12 prill 2012. **Ligji nr. 04/1-274**, ndërkaq, ka shërbyer si një bazë e re juridike për vazhdim të një mandati ekzistues (rimandatim), pra të një mandati të ri të gjyqtarëve kushtetues ndërkombëtarë që ishin caktuar në vitin 2009 sipas rregullave dhe procedurave të tjera në krahasim me zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetues vendor. Ato rregulla dhe procedura, megjithatë, për nga efekti juridik kanë qenë të barasvlefshme me zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetues vendorë, të cilën e bën **Kuvendi i Kosovës** dhe më pas dekretohen (emërohen) nga **Presidenti i Kosovës.**[58]

---

50 Mark E. Villiger, *Commentary on the 1969 Vienna Convention on the Law of Treaties*, fq. 175

51 Ibid., 176, 198.

52 Ibid., 201.

53 Neni 20.1 [Bartja e Sovranitetit] i Kushtetutës:
"1. Republika e Kosovës, në bazë të marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare, për çështje të caktuara mund të kalojë kompetenca shtetërore organizatave ndërkombëtare […]."

54 Cf. tekstin e Letërkëmbimit nr. 346 të datës 14 prill 2014, në fusnotën nr. 12, **supra**, në këtë kapitull si dhe komentet tona lidhur me të.

55 Neni 17.1 [Marrëveshjet Ndërkombëtare] i Kushtetutës: "1. Republika e Kosovës lidh marrëveshje ndërkombëtare dhe anëtarësohet në organizatën ndërkombëtare […]."

56 Neni 18.1 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] i Kushtetutës: "1. Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e dy të tretave (2/3) e të gjithë deputetëve ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare për këto çështje: (1) territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake;
(2) të drejtat dhe liritë themelore; (3) anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare;
(4) marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës […]."

57 *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 32* (Prishtinë, 15 maj 2014). Si aneks i këtij ligji është edhe teksti integral i letërkëmbimit si më sipër të datës 14 prill 2014 në mes të **Kosovës** dhe **Evropës**.

58 Këshilltarët ndërkombëtarë nuk ishin problem sepse ata nuk ishin staf i emëruar dhe për ta vlente vetëm baza juridike e kontratës së punës për vazhdim të mandatit të tyre, që mund ta lidhin në mënyrë autonome me autoritetet e **EULEX**-it.

Ani se me marrëveshjen e sipërcekur, të lidhur përmes **letërkëmbimit**, ishin bartur të drejtat sovrane të **Kosovës** për caktimin e personave ndërkombëtarë në gjyqësorin e rregullt, gjyqësinë kushtetuese, organin e akuzës, si dhe në disa pozita të tjera të natyrës administrativo-shtetërore (që kanë qenë të delegueshme, siç ishin punët në kuadër të agjensioneve të pavarura dhe organeve të tjera të administratës shtetërore në vend), dispozitat e saj nuk kanë pasur natyrë të **vetekzekutueshme**. Miratimi i një marrëveshjeje ndërkombëtare, siç ka qenë rasti me **Ligji nr. 04/L-274** të nxjerrë nga **Kuvendi i Kosovës** me qëllim të ratifikimit të marrëveshjes së sipërcekur, nuk duhet të ngatërrohet me normat tjera të përgjithshme apo me vendimet individuale të organeve shtetërore përmes të cilave inkorporohen në sistemin e brendshëm përmbajtjet materiale (substantive) të një marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare: ligji për ratifikim ka natyrën e një akti me të cilin parlamenti kryen (ushtron) kontrollin juridik dhe politik të një detyrimi kontraktual ndërkombëtar dhe nuk ka forcë autonome normative.[59] E njëjta gjë vlen edhe për marrëveshjet ndërkombëtare që nuk ratifikohen nga organi përfaqësues dhe ligjvënës.[60] Kjo, në rastin që diskutojmë, nënkupton që caktimi i gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit tjetër që i nënshtrohej regjimit të emërimit dhe që punonte nëpër agjencione dhe organe tjera shtetërore kosovare nuk ka mundur të bëhet me automatizëm. Dispozitat e marrëveshjes së arritur me letërkëmbimin si më sipër, me ratifikimin e tyre përmes **Ligjit nr. 04/1-274** janë futur, në aspektin formal, në sistemin juridik kosovar, duke u bërë kështu një pjesë e privilegjuar e këtij sistemi. Këto dispozita janë pjesë e privilegjuar e sistemit juridik-kushtetues kosovar sepse, në parim, dispozitat e një marrëveshjeje ndërkombëtare të ratifikuar gëzojnë një status më të lartë se çdo ligj i **Kuvendit të Kosovës**, por më të ulët se dispozitat e Kushtetutës së vitit 2008.[61] Ky status i privilegjuar i përcaktuar me Kushtetutë, nuk nënkupton se çdo marrëveshje e ratifikuar aktivizohet dhe vihet në jetë me automatizëm: për aktivizimin dhe vënien e tyre duhet ndërmarrja e një hapi tjetër juridik nga organi kompetent kushtetues, me të cilin iu jepet kuptim konkret dispozitave të tilla të marrëveshjeve që nuk kanë natyrë të **vetekzekutueshme**. Ligji për ratifikim, këtë duhet mbajtur mend, asnjëherë nuk ka natyrë normative sepse shërben vetëm si një instrument juridik për futjen në sistemin e brendshëm juridik të marrëveshjes ndërkombëtare që e ratifikon.[62] Kjo e fundit, marrëveshja ndërkombëtare, mund të mos ketë çdoherë dispozita që kanë fuqi të drejtpërdrejtë normative, përkatësisht dispozita të natyrës së **vetekzekutueshme**. Kur ky është rasti, pra kur marrëveshja e ratifikuar nuk përmban dispozita të vetekzekutueshme (me fuqi të drejtpërdrejtë normative), atëherë organi kompetent kushtetues duhet të nxjerrë aktin implementues të marrëveshjes.[63] Ky ka qenë rasti me marrëveshjen që diskutojmë për vazhdimin e mandatit të tre gjyqtarëve ndërkombëtar në Gjykatën Kushtetuese si dhe të personave të tjerë të sipërpërmendur. Ai akt implementues, në rastin që diskutojmë, ka konsistuar

---

59 **Pierre Pescatore,** *Conclusion et effet des traités internationaux: selon le droit constitutionnel, les usages et la jurisprudence du Grand-duché de Luxembourg*. Office des Publications de l'Etat: Louxembourg, 1964 &, ripublikuar në Bruylant: Bruxelles, 2009) fq. 58.

60 Këtu është fjala për ndarjen e traktateve në aspektin kushtetues që bëhet në **sistemin kushtetues austriak**: në grupin e traktateve që bien ndesh me legjislacionin vendor ekzistues dhe në grupin e traktateve që plotësojnë legjislacionin ekzistues. Në grupin e parë hyjnë traktatet që prekin vetë ekzistencën e shtetit, integritetin e tij territorial dhe pavarësinë, e që zakonisht emërtohen si traktate politike, kurse në të dytin hyjnë traktatet tjera që nuk e kanë këtë natyrë. Në kontekstin kosovar, grupin e parë e normojnë dispozitat e paragrafit të parë të nenit 18 të Kushtetutës, kurse grupin e dytë hyn dispozita nga paragrafi i dytë i njëjtit të njëjtë. Ky dallim, në fakt, ekziston në të gjitha kushtetutat e vendeve demokratike; Për komentet në doktrinë, cf. *Maja Nastić*, "Constitutional Rievew of International Agreements: Comparative Law Perspective". *Law and Politics* (FACTA UNIVERSITATIS: University of Niš, Faculty of Law, Serbia) Vol. 13 No. 1 (2015) fq. 59-72 në fq. 61-62.

61 Neni 19.2 ["Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare"] i Kushtetutës:
"[…] 2. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës."

62 Neni 19.1 ["Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare"] i Kushtetutës:
"1. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi të botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji […]."

63 Këtu bëhet fjalë për nxjerrjen e një ligji implementues të marrëveshjes së ratifikuar ndërkombëtare, mirëpo në praktikën kushtetuese dhe ndërkombëtare me këtë nënkuptohet nxjerrja e çfarëdo akti juridik me të cilin vihen në jetë dispozitat e marrëveshjes së ratifikuar ndërkombëtare, dispozita që nuk kanë natyrë të vetekzekutueshme (fuqi të drejtpërdrejt normative). Në këtë rast që diskutojmë, **akti implementues ka pasur natyrën e dekretit presidencial**, një akt juridik i Shefit të Shtetit me të cilin vihet në jetë (konkretizohet) një dispozitë e përgjithshme në kuadër të ushtrimit të kompetencave kushtetuese të këtij organi (Presidentit të Republikës). Ky autorizim, pra dekretimi, parqet një prej autorizimeve kushtetuese të këtij organi shtetëror. Në rastet tjera, akti juridik implementues i dispozitave të një marrëveshjeje ndërkombëtare që nuk kanë natyrë të vetekzekutueshme mund të ketë formë dhe përmbajtje tjetër. Zakonisht vetë dispozitat e marrëveshjes së ratifikuar ndërkombëtare përmbajnë parametrat që dëftojnë për rrugët që duhen ndjekur dhe masat që duhen marrë për vënien në jetë të dispozitave të saj që nuk kanë natyrë të vetekzekutueshme.

në ndërmarrjen e hapit shtesë dhe konkret nga ana e **Presidentit të Republikës** për riemërim (dekretim) të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe personave të tjerë që iu janë nënshtruar emërimit (bazuar në marrëveshjen e ratifikuar me **Ligjin nr. 04/L-274**, e cila ishte lidhur përmes letërkëmbimit në mes të **Kosovës** dhe **BE**-së, siç u përshkrua më lart; teksti i letërkëmbimit ka qenë shtojcë integrale e ligjit në fjalë).

Ky dekretim nga ana e Presidentes **Jahjaga** ishte pjesë përbërëse e një detyrimi ndërkombëtar të Kosovës, të marrë përmes letërkëmbimit si më sipër dhe ratifikimit të tij në Kuvend, pra përmes një marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar me **Ligjin nr. 04/L-274**. Këtë prerogativë për dekretim në vijim të vënies në jetë të këtij detyrimi ndërkombëtar të **Kosovës** e shfrytëzoi ish-Presidentja, **Atifete Jahjaga,** me nxjerrjen e dekretit nr. **DKGJK-001-2014** të datës 31gusht 2014, duke iu dhënë kësisoj jetë dispozitave të marrëveshjes së arritur me letërkëmbimin e ratifikuar me **Ligjin nr. 04/L-274**. Ky i fundit, pra **Ligji nr. 04/L-274**, nuk ka pasur asnjë fuqi normative: ai ka shërbyer ekskluzivisht si një teknikë standarde juridike për futjen në rendin e brendshëm juridik-kushtetues të **Kosovës** të dispozitave të marrëveshjes ndërkombëtare të lidhur përmes letërkëmbimit si më sipër në mes të **Kosovës** dhe **BE**-së. Dekreti si më sipër i Presidentes Jahjaga ka riemëruar (rimandatuar) tre gjyqtarët ndërkombëtar ekzistues të kohës në Gjykatës Kushtetuese, respektivisht gjyqtarët **Robert Carolan**, **Almiro Rodrigez** dhe **Snezhana Botusharova.**

Se ligjet për ratifikim të traktateve ndërkombëtare në përgjithësi nuk kanë asnjë fuqi dhe përmbajtje autonome normative e ka thënë vetë **Gjykata Kushtetuese** në rastin **K0 95/13:** me këtë vendim, ajo e pat bërë të qartë se në sistemin kushtetues kosovar nuk ekziston as kontrolli **ex post** apo **represiv** (pas hyrjes në fuqi) dhe as kontrolli **ex ante** apo **preventiv** (para hyrjes në fuqi) të kushtetutshmërisë së marrëveshjeve.[64] Një autorizim i tillë i gjyqësisë kushtetuese ekziston në një numër shumë të vogël të shteteve dhe atë kryesisht sa i përket kontrollit **ex ante** (**preventiv**) të kushtetutshmërisë së traktateve.[65] Vendet që kanë futur kontrollin **ex post** (**represiv**) të kushtetutshmërisë së traktateve ndërkombëtare janë shumë të rrallë: kjo përvojë ka nisur me **Austrinë** në vitin 1964, kur një amendament kushtetues ia njohu **Gjykatës Kushtetuese të Austrisë (GJKAu)** juridiksionin e kontrollit **ex ante** (represiv) të kushtetutshmërisë së trak-

---

64 *Rasti KO 95/13. Aktgjykim. Parashtrues: Visar Ymeri dhe 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit, Nr. 04/L-199, për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të Planit të zbatimit për këtë marrëveshje.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.:AGJ469/13. Prishtinë, më 9 shtator 2013. Paragrafët 99-101.

65 Ky lloj i kontrollit kushtetues të traktateve ndërkombëtare ka nisur për herë të parë në **Francë** në vitin 1958 dhe më pastaj është përhapur gjerësisht në vendet tjera të **Evropës**, **Afrikës** dhe **Amerikës Latine** përmes autorizimit shprehimor të parashikuar në tekstin e kushtetutës nacionale. Ka pasur raste, megjithatë, kur autorizimi për kontroll preventiv të kushtetutshmërisë së traktateve ka lindur si rezultat i praktikës gjyqësore. I tillë është rasti me **Gjermaninë** dhe **Irlandën.** Cf. Mario Mendez, "Constitutional Review of Treaties: Lessons from comparative constitutional design and practice". *International Journal of Constitutional Law* Vol. 15 No. 1 (2017) fq. 84-109 në fq. 95-96, 103, 105-108.
Në **Evropë**, vendet që përkrahin kontrollin preventiv të traktateve ndërkombëtare janë: **Bullgaria** (neni 149 i Kushtetutës së vitit 1991), Çekia (neni 87.2 i Kushtetutës së vitit 1993), **Gjeorgjia** (neni 65.4 i Kushtetutës së vitit 1994), **Polonia** (neni 133.2 i Kushtetutës së vitit 1999), **Portugalia** (neni 278 i Kushtetutës së vitit 1978), **Rumania** (neni 146. b i Kushtetutës së vitit 1991), **Rusia** (neni 125.2.b i Kushtetutës së vitit 1993), **Sllovenia** (neni 160 i Kushtetutës së vitit 1991), **Sllovakia** (neni 125.a 1 i Kushtetutës së vitit 1992), **Spanja** (neni 95.2 i Kushtetutës së vitit 1978), **Shqipëria** (neni 131.b i Kushtetutës së vitit 1998). Në **Afrikë**, lista jo e plotë përfshin këto vende ku përqafohet modeli preventiv: **Algjeria** (neni 165 i Kushtetutës së vitit 1989), **Angola** (neni 228 i Kushtetutës së vitit 2010), **Benini** (neni 146 i Kushtetutës së vitit 1900), **Bregu i Fildishtë** (neni 95 i Kushtetutës së vitit 2000), **Burkina Faso** (neni 150 i Kushtetutës së vitit 1991), ***Çadi*** (neni 220 i Kushtetutës së vitit 1996), **Gaboni** (neni 113 i Kushtetutës së vitit 1991), **Kameruni** (neni 47.3 i Kushtetutës së vitit 1972), **Madagaskari** (neni 116.1 i Kushtetutës së vitit 2010), **Mauritania** (neni 79 i Kushtetutës së vitit 1991), **Maroku** (neni 55 i Kushtetutës së vitit 2011), **Nigeri** (neni 120 & 170 i Kushtetutës së vitit 2010), **Senegali** (neni 97 i Kushtetutës së vitit 2001), **Tunizia** (neni 120 i Kushtetutës së vitit 2014).
Së fundi, lista jo e plotë e vendeve në **Amerikën Latine** që kanë përqafuar modelin preventiv të kontrollit si më sipër përfshin: **Bolivia** (neni 202.9 i Kushtetutës së vitit 2009), **Ekuadori** (neni 438.1 i Kushtetutës së vitit 2008), **Guatemala** (neni 272.e i Kushtetutës së vitit 1985), **Kili** (neni 93.3 i Kushtetutës së vitit 1980), **Kolumbia** (neni 272. a i Kushtetutës së vitit 1985), **Republika Dominikane** (neni 185.2 i Kushtetutës së vitit 2010), **Venezuela** (neni 336. 5 i Kushtetutës së vitit 1999).

tateve ndërkombëtare.[66] Këto vende zakonisht përdorin metoda ligjore dhe rrugë të tjera për të zbutur efektin eventual negativ të këtij kontrolli me qëllim të zbutjes s efekteve të tij, ruajtjes së komunikimit ndërkombëtar dhe emrit të mirë të shtetit në planin e jashtëm. I tillë është rasti me, ta zëmë, **Serbinë, Kilin** dhe **Spanjën**. Përveç kësaj, rrethi i palëve të autorizuara për ngritjen e kontrollit represiv të kushtetutshmërisë së traktateve është shumë i ngushtë, afatet kohore janë tepër të shkurta.

Kjo ka bërë që, në praktikë, kontrolli kushtetues **ex post** (**represiv**) i kushtetutshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare të jetë shumë i rrallë.[67] Në këtë kontekst, vlen të theksohet se edhe **Komisioni Venecias** ka dalë kundër kontrollit **ex post** (**represiv**) të marrëveshjeve ndërkombëtare, duke përkrahur vetëm kontrollin **ex ante** (**preventiv**) të kushtetutshmërisë së tyre. Tendenca e shteteve, sipas Komisionit, është që të harmonizohen rendet e brendshme juridiko-kushtetuese me detyrimet ndërkombëtare që shtetet kanë marrë përsipër.[68] Kjo kompetencë, në fakt, bie ndesh me modelin **kelsenian/evropian** të gjyqësisë

---

66 Vendet që kanë futur këtë sistem të kontrollit kushtetues përmes autorizimit shprehimor kushtetues janë po aq në numër sa vendet në të cilat ky juridiksion është futur përmes jurisprudencës (praktikës gjyqësore). Cf. Mario Mendez, "Constitutional Review of Treaties: Lessons from comparative constitutional design and practice", fq. 96.
Vlen të shënohet këtu se në rastin e vendeve që përqafojnë kontrollin **ex post** (**represiv**) të kushtetutshmërisë së traktateve ndërkombëtare, nuk do të thotë se vendimi i gjykatës vendore me të cilën konstatohet kundërkushtetutshmëria shfuqizon apo abrogon traktatin ndërkombëtar në fuqi. Ai vendim ka efekt ekskluzivisht të brendshëm dhe assesi ndërkombëtarë. Për të pasur një efekt të tillë ndërkombëtar, autoritetet nacionale duhet të ndjekin procedurat përkatëse të parashikuara me **KVDT** lidhur me daljen nga traktati në mënyrë ligjërisht të pranueshme: vendimi i gjykatës kushtetuese nacionale ka vetëm efekt deklarativ, asgjë më shumë. Cf. *Maja Nastić*, "Constitutional Rievew of International Agreements: Comparative Law Perspective", fq. 62, 64, 66, 67, 69 (duke marrë për bazë analizën e pesë shteteve: **Austrinë**, **Gjermaninë**, **Francën**, **Spanjën** dhe **Serbinë**).
Vendet në të cilat kontrolli **ex post** (represiv) i kushtetutshmërisë së traktateve ndërkombëtare është futur përmes autorizimit shprehimor në tekstin kushtetues janë: Angola (neni 227 & 230 i Kushtetutës së vitit 2010), Brazili (neni 102. IIIb i Kushtetutës së vitit 1988), **Meksika** (neni 105 II i Kushtetutës së vitit 1917), **Polonia** (neni 188.1 i Kushtetutës së vitit 1997), **Portugalia** (nenet 277, 280 & 281), **Serbia** (neni 167). Në **Spanjë**, ky juridiksion ekziston, por nuk është i përcaktuar me kushtetutën nacionale: **Ligji Organik Nr. 2/1979 mbi Gjykatën Kushtetuese**, datës 3 tetor 1979, ka parashikuar një juridiksion të tillë të kontrollit **ex ante** (**represiv**) të kushtetutshmërisë së traktateve ndërkombëtare në nenin e vet 10.1.a.
Vendet në të cilat kontrolli **ex post** (represiv) i kushtetutshmërisë së traktateve ndërkombëtare është futur përmes jurisprudencës (praktikës gjyqësore) janë: **Belgjika**, **Kili**, **Gjermania**, **Italia**, **Japonia**, **SHBA**-të dhe **BE**-ja. Në shumicën e këtyre shteteve, kontrolli **ex post** (**represiv**) i kushtetutshmërisë së traktateve ndërkombëtare kryhet përmes rrugës së tërthortë, përkatësisht përmes kontrollit kushtetues të akteve vendore që miratojnë traktatet ndërkombëtare (**Belgjika, Kili, Gjermania** dhe **BE-**ja). Cf. Mario Mendez, "Constitutional Review of treaties: Lessons from comparative constitutional design and practice", fq. 96, fusnotat 79 & 80 dhe literatura e cituar aty.
Në rastin e **Gjermanisë**, arsyetimi për një gjë të tillë konsiston në faktin se traktatet ndërkombëtare shndërrohen në ligj vendor që më pastaj duhet të zbatohet nga ana e autoriteteve vendore. Cf. *Maja Nastić*, "Constitutional Rievew of International Agreements: Comparative Law Perspective", fq. 63.

67 Në **Austri**, ku ka lindur ky sistem i kontrollit, asnjëherë nuk ka ndodhur që të ushtrohet kontrolli kushtetues **ex post** (**represiv**) i një traktati ndërkombëtar. Kjo për arsye se një vendim i **GJKAu** që shpall jokushtetues një traktat ndërkombëtar nuk ia humb atij fuqinë juridike në planin ndërkombëtar. Në fakt, një vendim i tillë paraqet detyrim dhe përgjegjësi ndërkombëtare për Austrinë. Cf. Mario Mendez, "Constitutional Review of treaties: Lessons from comparative constitutional design and practice", fq. 5, 101 (fusnota nr. 105 dhe komentet që e shoqërojnë), 102, 107 (komentet dhe referimet në fusnotën nr. 123); Cf. po ashtu edhe *Maja Nastić*, "Constitutional Rievew of International Agreements: Comparative Law Perspective", fq. 60-62, 67 (ku autori diskuton përgjegjësinë ndërkombëtare të shteteve në rast se vjen deri te shpallja jokushtetuese e një traktati ndërkombëtar, si dhe çështjet tjera krejtësisht teorike lidhur me kontrollin **ex post** të kushtetutshmërisë, siç janë natyra deklarative e vendimeve, synimi për ruajtjen e kredibilitetit ndërkombëtar të shtetit etj.).

68 Ka shtete që shprehimisht me kushtetutë ndalojnë ushtrimin e kontrollit **ex post** (represiv) të kushtetutshmërisë së traktateve ndërkombëtare. Të tilla janë, ta zëmë, **Luksemburgu** (neni 95t paragrafi 2 i Kushtetutës së vitit 1868), **Holanda** (neni 120 i Kushtetutës së vitit 1815), **Turqia** (neni 90. 5 i Kushtetutës së vitit 1982); Për qëndrimin si më sipër të **Komisionit të Venecias**, cf. më shumë në European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Opinion on the Constitution of Serbia*, adopted by the Commission at its 70th plenary session (Venice, 17-18 March 2007). **CDL-AD(2007)004.** Opinion No. 405/2006. Or. Engl. **Strasbourg**, 19 March 2007. Paragrafët: 14-17 & 81. Në internet: http://www.venicecoe.int/webforms/documents / default. aspx? pdffile=CDL-AD(2007)004-e (shikuar në mars 2018); Po ashtu, cf. edhe këtë arsyetim të Komisionit: "[...] A denunciation of an already valid treaty due to its non-conformity with the Constitution does not represent the optimum approach of the state to the valid norms of international law and values enshrined thereof. The general tendency is to rather harmonize legal orders of states (including constitutions) with their international obligations". European Commission for Democracy through Law (Venice Commission), *The Compilation of Venice Commission Opinions, Reports and Studies on Constitutional Justice.* **CDL-PI(2015)002**. Or. Engl. **Strasbourg**, 1 July 2015, fq. 47. Në internet: http://www.venice.coe.Int /webf orms/documents/?pdf=CDL-PI%282015%29002-e (shikuar në mars 2018).

kushtetuese dhe vetë pikëpamjet e **Hans Kelsen**, i cili kishte thënë se gjykatat kushtetuese, në parim, nuk do të duhej të posedonin të drejtën e ushtrimit të kontrollit kushtetues **ex post** (**represiv**) të marrëveshjeve ndërkombëtare. Kjo sepse, gjithnjë sipas **Hans Kelesen**, një autorizim i tillë do të prishte sigurinë në komunikimin ndërkombëtar në mes të shteteve (**pacta sunt servanda**) dhe do të ishte në kundërshtim me njërin prej atributeve kryesore të një shteti sovran dhe të pavarur - aftësinë e tij për të hyrë në marrëdhënie ndërkombëtare.[69] Këtë qëndrim të pastër kelsenian, siç u shtjellua më sipër, e ka mbajtur edhe **Gjykata Kushtetuese** në rastin e sipërcekur **KO 95/13.**[70] Më këtë rast, Gjykata e ka bërë shumë të qartë se ratifikimi nga përfaqësuesi i sovranit, **Kuvendi i Kosovës**, e bën të pa objekt çdo kontroll të kushtetutshmërisë: akti i ratifikimit me ligj nënkupton se Kuvendi pranon si të vetin çdo detyrim ndërkombëtar që kanë krijuar apo marrë përsipër organet kompetente kushtetuese (presidenti, kryeministri dhe ministri i jashtëm dhe organet tjera sipas autorizimit).[71]

Përgjatë këtyre vijave ka qenë përgjigja e Gjykatës në rastin e sipërcekur **KO 155/14**. Ky rast qe nisur nëntë ditë pasi gjyqtari ndërkombëtar **Robert Carolan** kishte marrë kontratën e re me **EULEX**-in si dhe një tjetër ndaras me donatorët ndërkombëtar të Kosovës. Kjo e fundit ishte pasojë imediate e shantazhit të tij për rritje të rrogës: gjyqtari në fjalë u kthye në punë më datën 1 tetor 2014, kurse kërkesën për kontroll kushtetues të dekretit për riemërim (rimandatim) të gjyqtarëve ndërkombëtarë të **Presidentes Jahjaga** e kishte bërë **Avokati i Popullit** më datën 9 tetor 2014.[72] Në kërkesë binte në sy vetëm një argument që mëtonte të kishte natyrë juridike: **Avokati i Popullit** theksonte se letërkëmbimi i fundit i Baroneshës **Katherin Ashton** me Presidenten **A. Jahjaga** kishte lënë anash gjyqtarët kushtetues ndërkombëtarë sepse nuk kishte përsëritur **ad literam** fjalët e kësaj të fundit, të cilat kjo i kishte shkruar në letrën e parë me të cilën propozonte vazhdimin e mandatit të gjyqtarëve kushtetues, gjyqtarëve të rregullt, prokurorëve, si dhe personave tjerë ndërkombëtarë që ushtronin detyra, funksione dhe kryenin punë në kuadër të sistemit juridik-kushtetues të **Kosovës**. Një rrethanë e tillë, sipas **Avokatit të Popullit**, përbënte shkelje kushtetuese dhe, për pasojë, gjyqtarët kushtetues ndërkombëtarë nuk mund të ushtrojnë funksionet e tyre si pasojë e kësaj shkelje kushtetuese. Sipas tij, e drejta për propozim të gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese kishte ngelur te Kuvendi dhe nuk ishte deleguar përmes letërkëmbimit në fjalë te asnjë organ tjetër kushtetues kosovar. Kjo ishte kështu, sipas interpretimit të tij të nenit

---

69 Kjo pikëpamje e **Hans Kelsen** në tërësi është në përputhje me konceptin e tij monist dhe supremacinë (epërsinë) e të drejtës ndërkombëtare. Në veçanti, kur bëhet fjalë për marrëveshjet ndërkombëtare, **Hans Kelsen** në tërësi përkrahë teorinë dhe praktikën mbi supremacinë (epërsinë) e të drejtës ndërkombëtare kontraktuale ndaj të drejtës së brendshme (kushtetuese) si pasojë e parimit **pacta sunt servanda.** Jo vetëm kaq, një kontroll i tillë mohon njërin nga atributet e sovranitetit shtetëror – kapacitetin e shtetit për të hyrë në marrëdhënie ndërkombëtare në mënyrë sovrane dhe të pavarur. Nëse vërtetë duhet të bëhet kontrolli kushtetues i marrëveshjeve ndërkombëtare, atëherë ai duhet të kryhet nga ana e një gjykate kushtetuese, jo nga gjyqësori i rregullt apo ndonjë organ tjetër, konstaton **Hans Kelsen**. Cf. Hans Kelsen, "La garantie juridictionnelle de la Constitution (La Justice constitutionnelle)", fq. 211-212.
Në literaturën më të re, ka autorë që angazhohen për futjen në përdorim të dy llojeve të kontrollit dhe besojnë se kjo mund të bëhet në pajtim me standardet e të drejtës ndërkombëtare. Kjo qasje, megjithatë, nuk bazohet në **premisën kelseniane** mbi sistemin **monist** të së drejtës, por mbi mundësinë teknike të zbatimit të dy llojeve të kontrollit kushtetues pa prekur (cenuar) standardet e të drejtës ndërkombëtar mbi komunikimin ndërkombëtar. Në fakt, këta autorë besojnë se kontrolli kushtetues i traktateve ndërkombëtare në dy format e tij rritë legjitimitetin e të drejtës ndërkombëtare, duke i dhënë asaj një element të përfaqësimit demokratik të shteteve përbërëse të bashkësisë ndërkombëtare. Cf. më shumë për këtë në shkrimin e sipërcekur të **Mario Mendez**, fusnotat nr. 65, 66 & 67, **supra**, në këtë seksion, si dhe komentet tona me to.

70 Paragrafi 94 i Aktgjykimit në rastin nr. **KO 95/13**: "[…] 94. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se marrëveshjet ndërkombëtare shërbejnë për plotësimin e një nevoje themelore të shteteve për të rregulluar, me pëlqim, çështjet e shqetësimit të përbashkët, dhe kësisoj të sjellin stabilitet në marrëdhëniet e tyre reciproke. Pra, marrëveshjet ndërkombëtare janë instrument për të siguruar stabilitet, besueshmëri dhe rend në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe, rrjedhimisht, marrëveshjet gjithmonë kanë qenë burim kryesor i marrëdhënieve juridike ndërmjet shteteve." Cf. edhe Mario Mendez, "Constitutional Review of treaties: Lessons from comparative constitutional design and practice", fq. 99.

71 Cf. paragrafët 78-92 i Aktgjykimit në rastin **KO 95/13.**

72 Në fakt, kërkesën e kishte paraqitur ushtruesi i detyrës së **Avokatit të Popullit**, zt. **Sami Kurteshi**, sepse kishte një vit që i kishte skaduar mandati. Një vit më vonë, ai do ta lë këtë pozitë dhe menjëherë do të futet në strukturat udhëheqëse të partisë politike kosovare, **Lëvizja Vetëvendosje**. Ky person nuk është me profesion jurist.

31.1 të **KVDT** që normon rregullën themelore për interpretimin e traktateve.[73] **Tërë** ky interpretim i shfytyruar dhe arbitrar i Kushtetues dhe i KVDT nuk mund të bëhej veçse nga një person që nuk kishte njohuri themelore për të drejtën kushtetuese dhe të drejtën ndërkombëtare. Ai person, megjithatë, ishte **Avokati i Popullit** i Kosovës.

Pretendimi i kërkesës së **Avokatit të Popullit**, përkatësisht pretendimi i tij për mangësi juridike në letërkëmbimin në mes të **Kosovës** dhe **BE-së**, që shërbeu si bazë për dekretim të gjyqtarëve ndërkombëtarë në postet ekzistuese në Gjykatën Kushtetuese, nuk ishte pos një keqkuptim thelbësor i natyrës juridike dhe përmbajtjes së **letërkëmbimit** si teknikë për krijimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Këtë e kemi sqaruar më sipër: nenet 11 dhe 13 të **KVDT**, që normojnë letërkëmbimin si njërën ndër format standarde për lidhjen e një marrëveshjeje ndërkombëtare, kanë natyrë të normës zakonore të së drejtës ndërkombëtare: në këtë pikë, përkatësisht sa i përket **letërkëmbimit** si mjet për arritjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, flet për elementet objektive e subjektive që çdoherë duhen marrë parasysh në çdo interpretim të objektit dhe qëllimit të marrëveshjes së arritur ndërkombëtare. Për më tepër, **letërkëmbimet** përgjatë historisë janë interpretuar duke marrë parasysh tërë korrespondencën e shkruar, historikun dhe qëllimet e palëve kontraktuese, jo vetëm tekstin **ad literam** që palët eventualisht e kanë përsëritur gjatë procesit të negocimit. Ajo që ka rëndësi është se instrumentet që shkëmbehen në një letërkëmbim të kenë lidhje ndërmjet veti, d.m.th. që njëra palë mos të flasë për gjëra që nuk kanë lidhje me ato që i flet dhe *përçon* pala tjetër në letërkëmbim.[74] Jo vetëm kaq! Më herët u theksua se nuk është e domosdoshme që një letërkëmbim në tërësi të përsërisë **ad literam** fjalët e palës tjetër.

---

[73] Cf. pjesën **Argumentet e paraqitura nga parashtruesi të** Aktgjykimit në rastin **KO 155/14**, të cilat reprodukojnë argument kryesore të paraqitura nga parashtruesi, **Avokati i Popullit**:
" […] 23. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se *"vazhdimi i mandatit të tre gjyqtarëve ndërkombëtarë pa propozimin e Kuvendit, nuk justifikohet* nga *përmbajtja* e *marrëveshjes ndërkombëtare* e *vitit 2014 midis Republikës* së *Kosovës dhe Bashkimit Evropian".* […].
25. Parashtruesi i kërkesës i referohet letrës së Presidentes së Republikës së Kosovës, të 14 prillit 2014, ku *inter alia* thuhet si në vijim: *"Neni 20 i Kushtetutës* së *Republikës* së *Kosovës i lejon Republikës qe t'i bart disa kompetenca, për çështje specifike, tek organizatat ndërkombëtare. [...] Kështu, në bazë të nenit* 20 *te Kushtetutës* së *Republikës* së *Kosovës, unë ju konfirmoj që kompetencat ne vijim* do *t'i delegohen misionit EULEX KOSOVA- (a) të emërojë gjyqtarë, sipas neneve* 65, *108,* 114, *respektivisht* 84, *të Kushtetutës, duke iu nënshtruar edhe konfirmimit të atyre emërimeve nga Presidenti, pas pëlqimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës [...]".*
26. Parashtruesi i kërkesës argumenton se *"megjithëse nuk specifikon që* do *t'i delegohet EULEX-it kompetenca për të emëruar gjyqtarë, posaçërisht të Gjykatës Kushtetuese, ky paragraf [referenca* e *lartpërmendur në letrën] i referohet nenit 114 [i Kushtetutës], i cili e ka titullin "Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese" dhe i cili përcakton se "[g]gjyqtarët emërohen nga Presidenti i Republikës* së *Kosovës,* me *propozimin* e *Kuvendit" (neni 114.2)."*
27. Parashtruesi i kërkesës më tej konsideron se, *"sipas nenit 20, në mënyre që të delegohet një kompetencë tek një organizatë ndërkombëtare, ai delegim duhet të bazohet në* një *marrëveshje ndërkombëtare" [..]. ''Në rastin* e *marrëveshjes midis Republikës* së *Kosovës dhe Bashkimit Evropian, letra* e *palës* së *parë, Republika* e *Kosovës,* e *përfaqësuar nga Presidentja Jahjaga, i bëri ftesë Bashkimit Evropian, të përfaqësuar nga baronesha Ashton, që të vazhdojë qëndrimin* e *EULEX-it deri në vitin 2016. Si pjesë e kësaj ftese, Presidentja Jahjaga propozoi që EULEX-i të marrë përsipër një sërë kompetencash, duke përfshirë kompetencën* e *emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Sipas procedurës* së *zakonshme […] përgjigja e baroneshës Ashton duhej të ishte një letër që i jep përgjigje palës* së *parë "duke* e *riprodhuar përmbajtjen* e *plotë të letrës origjinale dhe duke* e *shprehur pëlqimin mbi te".*
28. Sipas parashtruesit të kërkesës, kjo nuk ndodhi, por përgjigjja ishte e thjeshtë dhe aty thuhej si në vijim: *"E pranoj ftesën* e *bërë në letrën tuaj të datës 14 prill për të vazhduar zbatimin* e *mandatit të EULEX-it në Kosovë, siç është cekur në Veprimin* e *Përbashkët 2008/124/CFSP, të miratuar nga Këshilli* i *Bashkimit Evropian* më *datën 4 shkurt 2008 dhe të ndryshuar, në frymën* e *bashkëpunimit të ndërsjellë".*
29. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës pretendon se *"Veprimi* i *Përbashkët* e *autorizon EULEX-in që të veprojë vetëm brenda institucioneve të krijuara në bazë të Rezolutës 1244. [...]. Meqenëse Gjykata Kushtetuese nuk ka qenë institucion* i *krijuar sipas Rezolutës* 1244, *është* e *qartë* se *kompetenca për të emëruar gjyqtaret* e *kësaj Gjykate* do *ta sillte EULEX-in jashtë kornizës* së *Veprimit te Përbashkët. Prandaj, delegimi* i *kompetencës* së *emërimit tek EULEX-i nuk* u *pranua zyrtarisht nga baronesha Ashton, dhe nuk është pjesë* e *mirëfilltë* e *marrëveshjes ndërkombëtare.*"
30. Parashtruesi i kërkesës pretendon, më tej, se Presidentja e Republikës së Kosovës, në letrën e saj të 14 prillit 2014, nuk i ka deleguar EULEX-it në mënyre të qartë dhe specifike kompetencën për propozimin e gjyqtarëve në pajtim me nenin 31, pika 1, të Konventës së Vjenës për Traktatet Ndërkombëtare. Prandaj, pretendohet se kompetenca për të propozuar gjyqtarë mbetet te Kuvendi i Republikës së Kosovës." […]".

[74] Cf. Mark E. Villiger, *Commentary on the 1969 Vienna Convention on the Law of Treaties*, fq. 199, fusnota nr. 16 dhe komenti që e shoqëron (autori përmend **Aegean Sea Continental Shelf (Greece/Turkey) Case**, i vendosur nga **GJND** në vitin 1978, si dhe autorët me renome që vërtetojnë këtë fakt, pra se mjafton që shkëmbimet e instrumenteve të kenë lidhmëni me njëri tjetrin apo nga rrethanat e rastit të del ekzistimi i përmbajtjes së caktuar të marrëveshjes së lidhur në mes të palëve përmes shkëmbimit të instrumenteve).

Kur një dispozitë juridike ka status të normës zakonore, asnjë mëdyshje për interpretimin e përmbajtjes së saj nuk ekziston në komunikimin në mes të shteteve. Kjo është kështu sepse çdoherë supozohet se një dispozitë të tillë i rri prapa një mal me praktikë të gjatë të zbatimit të saj në të kaluarën. Çdo detyrim ndërkombëtar duhet të interpretohet dhe zbatohet në mirëbesim (**bona fide**): në rastin konkret, nuk ka asnjë dyshim, atëherë dhe sot, se letra e parë e **Presidentes Jahjaga** e datës 14 prill 2014, nuk ka pasur ndonjë tjetër objekt dhe qëllim pos atij të rimandatimit (riemërimit) të gjyqtarëve të njëjtë në **Gjykatën Kushtetuese**. Po të ishte ndryshe, **BE përmes përfaqësuesit të vet në Prishtinë** do të kishte reaguar gjatë procesit të riemërimit të tyre sepse, fundja, ata kanë qenë gjyqtarët e saj ndërkombëtarë. **Avokati i Popullit këtë rrethanë dhe këtë qasje nuk e ka pasur parasysh, siç nuk e ka kuptuar asnjë pjesë të nenit 13 të KVDT,** natyrën juridike dhe efektet e marrëveshjeve ndërkombëtare të lidhura përmes letërkëmbimit sipas të drejtën ndërkombëtare kontraktuale.

Neni i 13-të i **KVDT** ka dy paragrafë. Sipas praktikës ndërkombëtare, zakonisht pala e dytë në një letërkëmbim i përsëritë **ad literam** fjalët e palës së parë, e cila është autori fillestar dhe pala e parë në letërkëmbim. Pala që nis letërkëmbimin, pala e parë, paraqet ofertuesin, kurse pala e dytë pranuesin e ofertës. Kjo është e qartë dhe e pakontestueshme. Për të qenë një letërkëmbim i vlefshëm, ai duhet të ketë qenë nga fillimi i parashikuar si i tillë nga ana e palëve. Kjo përcaktohet me paragrafin e dytë të nenit 13 të **KVDT**, i cili sqaron se rrethanat e rastit si dhe objekti e qëllimi që palët e kanë pasur parasysh me rastin e realizimit të **letërkëmbimit,** kanë relevancë të veçantë. Nuk mund të ketë rregulla të tjera të interpretimit, më fleksibile dhe më të buta, që të vlejnë për marrëveshjet e lidhura përmes shkëmbimit të instrumenteve: në të gjitha rastet, objekti dhe qëllimi, elementet objektive dhe subjektive, mbi të gjitha historia e negocimit, duhet të jenë pjesë përbërëse e çdo operacioni mendor që lidhet me interpretimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, pa marrë parasysh mënyrën e lidhjes së tyre.

Këtë nuk e ka kuptuar **Avokati i Popullit**, i cili, pa cituar asnjë autoritet ndërkombëtar nga fusha e traktateve ndërkombëtare dhe pa kuptuar se **letërkëmbimi** i takon të **drejtës zakonore ndërkombëtare**, për çka ekzistojnë me dhjeta raste që provojnë se nuk kërkohet domosdo përsëritja **ad literam** e fjalëve të palës tjetër. Përveç kësaj, ai nuk ka kuptuar se çdo rrethanë objektive e subjektive duhet të merret parasysh në mënyrë kumulative me rastin e interpretimit, njëjtë siç është rasti me interpretimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Në vend të kësaj, ai ka ardhur deri te një konstatim krejtësisht absurd, kur tha, në kërkesën e tij, se nuk kishte bazë kushtetuese për dekretim (rimandatim) të tre gjyqtarëve ndërkombëtar sepse **baronesha Katerin Ashton** si palë e dytë nuk kishte reciprokuar **Presidenten Jahjaga**, duke mos i përsëritur **ad literam** fjalët e saj si ofertues i parë i marrëveshjes së lidhur me **letërkëmbimin** e sipërcekur. Avokati besonte se kërkesa e vet kishte bazë në të drejtën ndërkombëtare dhe mund të arrinte një efekt kushtetues. Sipas tij, argumenti i kundërkushtetutshmërisë së rimandatimit të tre gjyqtarëve ndërkombëtarë konsistonte në atë se ishin shkelur normat e të drejtës ndërkombëtare kontraktuale. Ky argumentim, jo vetëm që nuk ishte i saktë, siç u pa më sipër, por, në aspektin kushtetues, nuk kishte asnjë bazë mbështetëse: objekt i kontrollit kushtetues ka qenë (dhe mund të jetë) vetëm dekreti i **Presidentit të Republikës**, asnjëherë një marrëveshje ndërkombëtare. Po ashtu, si parametër për vlerësim të kushtetutshmërisë asnjëherë nuk kanë mund të jenë dispozitat e **KVDT**:[75] vetëm dispozitat kushtetuese që normojnë formën dhe përmbajtjen e dekretit nga ana e Presidentit të Republikës, si dhe fryma

[75] Në seksionin 10.4 të kapitullit të 10 dhe në seksionin 11.3.3 të kapitullit 11 kemi treguar se i a.q. **kontroll i konvencionalitetit**, pra kontrolli kushtetues që ka për qëllim të konstatojë nëse një akt i brendshëm juridik (i përgjithshëm apo i veçantë) është në pajtim me një detyrim që burojnë nga ndonjë marrëveshje ndërkombëtare, në **Kosovë** ekziston vetëm si i përket amendamenteve kushtetuese: neni 113.3 në pikën 4 është jashtëzakonisht i qartë në këtë drejtim sepse përcakton që **Gjykata Kushtetuese** ka në juridiksion të saj vendosjen lidhur me përputhshmërinë e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, të ratifikuara sipas Kushtetutës dhe rishikimi i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur.

e Kushtetutës ashtu siç është interpretuar nga Gjykata në të kaluarën. Këtë e kemi diskutuar më herët **në seksionin e parë të kapitullit 11 të këtij libri.**

Përveç kësaj, **Kosova**, sikundër dihet, nuk i takon vendeve që ia njohin gjykatës së saj kushtetuese të drejtën e kontrollit kushtetues të marrëveshjeve dhe detyrimeve tjera ndërkombëtare, as **preventiv** (para hyrjes së tyre në fuqi) e as **represiv** (pas hyrjes së tyre në fuqi). As në këtë aspekt **Avokati i Popullit** nuk kishte arritur të argumentoj siç duhet: ai mëtonte rrëzimin e dekretit të sipërcekur të **Presidentes Jahjaga** për rimandatimin e tre gjyqtarëve ndërkombëtarë, me një kërkesë e cila mbi 90 për qind i referohej argumenteve të së drejtës ndërkombëtare mbi traktatet. **Gjykata Kushtetuese** e kishte vërejtur këtë fakt dhe kishte refuzuar me plot të drejtë rrëzimin e dekretit si më sipër të **Presidentes Jahjaga**, si një dekret i dhënë në tërësi në pajtim të plotë me Kushtetutën dhe detyrimet ndërkombëtare të **Kosovës**, të marra përsipër me rastin e ratifikimit të marrëveshjes së arritur përmes letërkëmbimit. E kemi fjalën për **Ligjin nr. 04/L-274** me të cilin është ratifikuar kjo marrëveshje.

Vetëm dy vite më vonë, në vitin 2016, sipas procedurës së njëjtë, bazuar në dispozita krejtësisht të njëjta kushtetuese, ishte arritur vazhdimi i mandatit të gjyqtarëve të njëjtë ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese (dhe i tjerëve që ishin pjesë e kontingjentit **të EULEX**-it dhe organeve e trupave të tjerë kushtetues kosovarë, të cilat i kemi zënë në gojë më sipër). Ky vazhdim përfshinte periudhën për vitet 2016-2018 dhe u bë më datën 17 qershor 2016, me miratimin e "**Ligjit nr. 05/L-102** për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë"(**Ligji nr. 05/L-102**).[76] Në përgjigjen **Federica Mogherini**-t, Përfaqësuese e Lartë e Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë, me të cilën formalizohej letërkëmbimi dhe arritja e marrëveshjes si më sipër, fare nuk përsëritet teksti i Presidentit të Kosovës, **Hashim Thaçi**, si iniciues (ofertues) për lidhjen e saj (sic!).

T'i kthehemi sërish diskutimit rreth rimandatimit të kryer pas mbarimit të fuqisë juridike të amendamentit nr. 22, sipas letërkëmbimit të parë të ratifikuar me **Ligjin nr. 04/L-274.** Rimandatimin e dytë për periudhën 2014-2016 nuk e diskutojmë fare sepse nuk ka asnjë dallim nga i pari dhe nuk ka prodhuar asnjë pasojë tjetër që do ta dallonte nga letërkëmbimi i parë, përveç pasojës së prodhuar nga orkestrimi skandaloz i aktakuzës nga ish-gjyqtari ndërkombëtar **Robert Carolan.**

Në ndërkohë që ata u rimandatuan, njëri prej tyre, gjyqtari **Robert Carolan**, sajoi tregimin për të a.q. **vetëpërjashtim nga rasti**: tha se kishte përjashtuar vetveten kur ishte vendosur rasti **KO 155/14** (ani se fjala ishte për rrogën e tij që tanimë e kishte siguruar dhe e dinte që nuk mund të shpallej jo kushtetues dekreti për rimandatimin e tij dhe të tjerëve) dhe u bë dëshmitar i fiktiv kundër autorit të parë të këtij libri, duke abuzuar me **imunitetin diplomatik në mënyrë të pashembullt për analet diplomatike. Këtë e shtjellojmë në seksionin më poshtë, i cili ka të bëjë me imunitetin dhe privilegjet e gjyqtarëve kushtetues, vendorë dhe ndërkombëtarë.**

Gjyqtari që tha se kishte përjashtuar vetveten nga vendosja në rastin **KO 155/14**, gjoja për shkak të konfliktit të interesit, asnjëherë nuk kishte menduar që do të duhej ta kthente rrogën e tij të majme, nëse vërtetë besonte se vazhdimi i mandatit të tij dhe dy kolegëve të tjerë ishte bërë në mënyrë antikushtetuese. Sikundër u sqarua më herët, koha e vërtetoi që pikërisht ai, së bashku me njërin prej tre gjyqtarëve ndërkombëtarë, kishin pasur problem me autoritetet kompetente ndërkombëtare për shkak të **korrupsionit** dhe **mashtrimit** nga ana e tyre. Pra, jo për shkak se rimandatimi kishte qenë dubioz në aspektin kushtetues, por sepse vetë ata ishin angazhuar në aktivitetet të pahijshme që nuk i takojnë gjyqtarëve kushtetues.[77]

---

[76] *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 21* (Prishtinë, 29 qershor 2016). Si aneks i këtij ligji është edhe teksti integral i letërkëmbimit nr. 535 të datës 13 qershor 2016 në mes të **Kosovës** dhe **Evropës**.

[77] Cf. fusnotat nr. 30, 80 & 206, në këtë kapitull.

12.2. Zgjedhja pas përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur

Pas pavarësisë së mbikëqyrur, ka pasur disa dështime për caktim të gjyqtarëve të rinj vendorë. Kushtet për caktimin e gjyqtarëve kushtetues dhe mandati i tyre përcaktohen me Kushtetutë, me **Ligjin nr. 03/L-121** dhe me **RP.** Këtu kryesisht shtjellojmë dispozitat kushtetuese, kurse ato ligjore dhe rregullat e brendshme të procedurës aq sa është e domosdoshme për të hedhur dritë në ndonjë segment që ka të bëjë me zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetues. Kjo qasje buron nga fakti i thjeshtë se Kushtetuta përcakton mandatin dhe përbërjen e Gjykatës, imunitetet, natyrën juridike dhe efektet e vendimeve si dhe çështjet tjera themelore që përcaktojnë modelin kosovar të gjyqësisë kushtetuese.

Dështimet në zgjedhjen e gjyqtarëve të rinj vendorë kanë ndodhur për arsye se **Kuvendi i Kosovës** asnjëherë, pas qershorit 2009, nuk ka arritur të kryejë zgjedhjen e gjyqtarëve të rinj për vendet e ngelura vakante. Kjo zgjedhje është dashur të jetë në mënyrë progresive për çdo tri vjet, me fillim nga qershori i vitit 2012 (për dy vendet e ngelura vakant). Gjyqtari i parë i ri u dekretua më 25 qershor 2012, kur gjyqtarja **Arta Rama – Hajrizi** e dha betimin para Presidentes së Kosovës, **Atifete Jahjaga**, kurse më 15 prill 2015, u plotësua vendi i dytë vakant me betimin e gjyqtarit të dytë **Bekim Sejdiu**, po ashtu para Presidentes **Jahjaga.**[78] Në ndërkohë, në qershor të vitit 2015, ka mbaruar mandati i kryetarit të Gjykatës, autorit të parë të librit, si dhe mandati i gjyqtarit **Kadri Kryeziu**. Këto dy vende janë plotësuar në dhjetor të vitit 2015, me zgjedhjen e dy gjyqtarëve të rinj, zonjave **Gresa Caka** dhe **Selvete Gerxhaliu** respektivisht.[79] Në shtator të vitit 2016, ka dhënë dorëheqje njëri prej tre gjyqtarëve ndërkombëtarë dhe, që nga ajo kohë, vendi ka ngelur vakant.[80] Kjo do të thotë se nga shtatori i vitit 2016 ka ngelur sërish vakant një pozitë, kurse në qershor të vitit 2018 pritej zgjedhja e pesë gjyqtarëve të rinj, të gjithë vendorë. Kjo sepse dy gjyqtarëve të mbetur ndërkombëtarë u skadoi kontrata në qershor të vitit 2018 dhe më nuk pat asnjë gatishmëri nga autoritetet ven-

---

78 Cf. "Presidentja Jahjaga dekretoi emërimin e zonjës **Arta Rama-Hajrizi**, gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese". Në internet: http://www.president-ksgov.net/sq/lajme/presidentja-jahjaga-dekretoi-emerimin-e-zonjes-arta-rama-hajrizi-gjyqtare-ne-gjykaten-kushtetuese (shikuar në shkurt 2018); "Presidentja Jahjaga dekretoi emërimin e **Bekim Sejdiut** gjykatës në Gjykatën Kushtetuese. Në internet: http://www.president-ksgov.net/sq/lajme/presidentja-jahjaga-dekretoi-emerimin-e-bekim-sejdiut-gjykates-ne-gjykaten-kushtetuese (shikuar në shkurt 2018).

79 Betimin e tyre e kanë dhënë tek **Presidentja Jahjaga** më datën 30 dhjetor 2015.

80 **Robert Carolan**, ka dhënë dorëheqje të detyrueshme, duke ikur nga Kosova më datën 9 shtator të vitit 2016. Kjo ka qenë dorëheqje reale, e dyta dhe e fundit. Për dorëheqjen e tij të parë dhe fiktive, të bërë me qëllim të rritjes së rrogës dhe motiveve tjera joprofesionale, cf. komentet tona në fusnotën nr. **19** të kapitullit 11 të këtij libri. Për dallim nga hera e parë, dorëheqja e datës 8 shtator 2016, ishte reale dhe e detyruar me dhunë për shkak të mosvazhdimit të kontratës së tij të punës nga ana e autoriteteve ndërkombëtare evropiane, misionit **EULEX** si punëdhënës i gjyqtarëve dhe këshilltarëve ndërkombëtar të **GJKRKS**. Ky mosvazhdim i kontratës së gjyqtarit ndërkombëtar, **Robert Carolan**, vinte si pasojë e drejtpërdrejtë e **hetimeve ndërkombëtare për korrupsion** që atëbotë zhvilloheshin kundër tij. Hetimet qenë nisur nga auditori anti-mashtrim i **Komisionit Evropian**, i njohur si **OLAF.** Përveç këtij shkaku të drejtpërdrejtë, në medie është raportuar se misioni **EULEX** kishte shprehur gatishmërinë për t'ia hequr **imunitetin diplomatik për t'u ballafaquar si i barabartë në gjyqin që zhvillohej kundër autorit të parë të librit,** ku si dëshmitarë fiktiv ishte vetë gjyqtari i dorëhequr **Robert Carolan**. Këtë rrethanë të raportuar ne medie për heqje të imunitetit si njëri ndër dy shkaqet për largim të tij e ka të vërtetuar me shkrim autori i parë i librit, në dy letra të dërguara nga vetë shefat e misionit EULEX. Për këtë flasim më vonë në këtë kapitull, në seksionin që ka të bëj me **imunitetin** e gjyqtarëve kushtetues; Për raportimet e medies kosovare lidhur me hetimet për korrupsion ndaj këtij gjyqtari dhe kërcënimin se misioni **EULEX** do t'ia heq imunitetin me qëllim të ballafaqimit si i barabartë në gjyqin kundër autorit të parë të këtij libri, ku vetë ishte si dëshmitarë fiktiv, cf. më shumë në shkrimet si vijon: "**EULEX**-i po hetohet për keqpërdorime". **KOHA DITORE**, e mërkurë, 22 qershor 2016; "Dorëhiqet gjyqtari Carolan".**KOHA DITORE**, datë 10 shtator 2016. Në internet: http://archive.koha.net/?id=27&l=132005 (shikuar në mars 2018); "Carolan do të zëvendësohet nga një vendës". **KOHA DITORE**, datë 4 tetor 2016. Në internet: http://archive.koha.net/?id=27&l=135739 (shikuar në mars 2018); **Malcolm Simons**, kryetar i gjyqtarëve të misionit **EULEX** në Kosovë në një intervistë të datës 16 nëntor 2017 për gazetën **Le Monde** të **Francës**, e riprodhuar në gjuhën shqipe në portalin kosovar **INSAJDERI** më datën 23 nëntor 2017 me titull "*E* dija *që është sistem i korruptuar*, *por e pranova postin"*, ka folur gjerësisht për hetimet për korrupsion ndaj gjyqtarit **Robert Carolan** (dhe gjyqtares tjetër të Gjykatës, znj. **Senezhana Botusharova**). Në internet: http://www.insajderi.com/e-dija-qe-eshte-sistem-korruptuar-por-e-pranova-postin/ (shikuar në mars 2018). **Malcolm Simons** ka qenë eprori përgjegjës për punën e gjyqtarëve ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese.

dore për ripërtëritje të mandatit të tyre. Kjo nënkupton se nga qershori 2018 nisi ripërtëritja e thellë dhe e parë e Gjykatës Kushtetuese, që nga zgjedhja e gjeneratës së parë të gjyqtareve kushtetuese në maj të vitit 2009.

Sa i përket mënyrës së caktimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, **Kosova** i takon **modelit të zgjedhjes**.[81] Në këtë model, organi përfaqësues ka fjalën kryesore në caktimin e gjyqtarëve të gjykatës kushtetuese. Një procedurë e tillë, megjithatë, vlen vetëm sa i përket caktimit të gjyqtarëve vendor: për gjyqtarët ndërkombëtarë, gjatë tërë kohës sa kanë qenë anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, ka vlejtur një version **sui generis** i **modelit të caktimit të drejtpërdrejtë**. Kjo për faktin se ata janë caktuar me emërim nga ana e **PCN** (2009-2014), përkatësisht nga ana e shefit të shtetit të kosovar (2014-2018), pa ndarë këtë autorizim për caktimin e tyre me asnjë organ tjetër, qoftë me **GJEDNJ** apo **Kuvendin e Kosovës**. Këto janë sqaruar gjerësisht në seksionin pararendës të këtij kapitulli.

Në rastin e gjyqtarëve vendorë, ndërkaq, procedura e **modelit të zgjedhjes**, e definuar si më sipër, normohet me nenin 114.2 të Kushtetues që flet për p**ërbërjen dhe mandatin e gjyqtarëve kushtetues. Në këtë nen thuhet:**

“ 2. Gjyqtarët emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Kuvendit, për një mandat nëntëvjeçar, pa mundësi vazhdimi”.

Sikundër shihet, në rastin e **Kosovës** nuk ekziston modeli i bashkëpunimit të organit përfaqësues dhe shefit të shtetit. Kjo nga shkaku se ky i fundit bën vetëm emërimin (dekretimin) tërësisht ceremonial të gjyqtarëve të zgjedhur nga Kuvendi. Ky sistem garantohet me Kushtetutë, e cila në mënyrë të qartë flet për këtë. Procedurat e vënies në jetë të këtyre dispozitave kushtetuese, të cilat garantojnë dhe sanksionojnë këtë **model të zgjedhjes** në **Kosovë**, specifikohen në dispozitat e **Ligjit nr. 03/L-121.** Para se të flasim për procedurën e vënies në jetë të sistemit kosovar të **modelit të zgjedhjes** në caktimin e gjyqtarëve kushtetues, duhet vënë në pah se propozimi i Kuvendit nuk mund të jetë homogjen: ai duhet të jetë mjaft divers dhe të reflektojë parimin themelor kushtetues mbi ruajtjen dhe sigurimin e diversitetit etnik, gjuhësor, kulturor dhe tjetër në **Republikën e Kosovës**. Kjo përbën një detyrim kushtetues. Mirëpo, në ndërkohë që konkurrimi për pozitën e gjyqtarit kushtetues është mjaft liberal dhe nuk pengon askënd që vlerëson se është jurist i shquar për të aplikuar **sua sponte** për pozitë të tillë, propozimi i Kuvendit duhet të jetë qartazi në harmoni me vlerat dhe parimet kushtetuese mbi barazinë e të gjithëve si dhe në respektim të parimit të mosdiskriminimit mbi asnjë bazë. Kjo, mbi të gjitha, ka të bëjë me vendet vakante për gjyqtarë nga radhët e komuniteteve jo

[81] Modeli parë është ai model në të cilin caktimi i gjyqtarëve është i ndarë në mes të dy apo më shumë organeve, të cilat veprojnë ndaras dhe në mënyrë të pavarur nga njëri tjetri. Secili organ ka kuotat e veta të gjyqtarëve që duhet t’i caktojë, zakonisht çdo tre vjet. Ky ndryshe quhet edhe **modeli i caktimit të drejtpërdrejtë**. Në këtë model bëjnë pjesë **Austria, Bullgaria, Franca, Italia, Rumania, Spanja, Ukraina** etj.; Modeili i dytë është ai model në të cilin gjyqtarët caktohen ekskluzivisht me votën e parlamentit. Ky model njihet me emrin **modeli i zgjedhjes**. Ekziston në **Gjermani** dhe në shumicën e vendeve ish-komuniste të Evropës, si Polonia dhe Hungaria, si dhe **Kosova.** Modeli i tretë është ai model në të cilin caktimi i gjyqtarëve bëhet përmes bashkëpunimit në mes të dy organeve, zakonisht ligjvënësit dhe shefit të shtetit. Ky model njihet me emrin **modeli i bashkëpunimit.** Si i tillë ekziston në **Shqipëri, Rusi, Slloveni, Sllovaki, Ceki** etj. Në këto vende nominimi bëhet nga shefi i shtetit e konfirmohet nga ligjvënësi, apo anasjelltas. Këtu në këtë model kërkohet një shkallë e lartë e kulturës së bashkëpunimit. Cf. më shumë për tri modelet në trajtimet doktrinare të autorëve si vijon: Zdenk Kühn and Jan Kysela, “Nomination of Constitutional Justices in Post-Communist Countries: Trial, Error, Conflict in the Czech Republic”. *European Constitutional Law Review* Volume 2 Issue 02 (June 2006) fq. 183 – 208 në fq. 185-188; Katalin Kelemen, “Appointment of Constitutional Judges in a Comparative Perspective – with a Proposal for a New Model for Hungary”. *Acta Juridica Hungarica* Vol. 54 No. 1 (2013) fq. 5-23 në fq. 11-19; Për një klasifikim pak më ndryshe të modeleve, cf. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *The Composition of Constitutional Courts*, paragrafi 1.1 [“Systems of Appointment”]: European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Judicial Appointments*. Venice, 22 June 2007. **Opinion No. 403 / 2006. CDL-AD(2007)028.** Or. Engl. Paragrafët: 8-17. Në internet: http://www.venice.coe.int/webforms/documents/CDL-AD(2007)028.Aspx (shikuar në prill 2018).

shumicë,[82] por, në të njëjtën kohë, i referohet edhe respektimit të barazisë gjinore dhe ndalimit të diskriminimit tjetër në fitimin dhe ushtrimin e posteve publike.[83]

Sikundër shihet, me propozim të Kuvendit,[84] i cili voton për kandidatët nga lista e përzgjedhur për postin e gjyqtarit kushtetues nga ana komisionit **ad hoc**, Presidenti i Republikës bën emërimin (dekretimin) formal të tyre.[85] Konkursi është publik, kurse konkurrimet, siç u tha më sipër, janë shumë liberale: nominimet për të konkurruar mund t'i bëjnë organet dhe institucionet e ndryshme, qeveritare dhe joqeveritare, si dhe vetë kandidatët që konkurrojnë (vetëkonkurrimi **sua sponte**).[86]

Procedura që vë në jetë dispozitat e mësipërme kushtetuese për caktimin e gjyqtarëve kushtetues rregullohet vetëm më një nen, me nenin 6 ["Procedura për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese"] të **Ligjit nr. 03/L-121**. Të shohim si duket kjo procedurë.

Çdoherë kur duhet të propozohet një gjyqtar kushtetues, formohet një komision i posaçëm, **ad hoc** në karakter, për udhëheqjen e procedurave të kandidimit deri në përpilimin e listës prioritare dhe dërgimin e saj në Kuvend për votim me qëllim të propozimit të gjyqtarëve për emërim (dekretim) te **Presidenti i Republikës**.[87] Komisioni reflekton përbërjen politike të Kuvendit, si dhe strukturën e sistemit gjyqësor, institucioneve të pavarura, diversitetin kulturor, etnik, gjuhësor dhe tjetër. Në të merr pjesë edhe përfaqësuesi i Gjykatës Kushtetuese.[88] Në respektim të organit që propozon kandidatët, kryesimi i këtij komisioni i takon kryetarit të Kuvendit apo përfaqësuesit të deleguar prej saj/tij. Kjo rrethanë, pra roli kyç i Kuvendit, shpjegon përse i vetmi është posti i kryetarit të Kuvendit që mund të delegohet në një tjetër person brenda

---

82 Neni 114.3 ["] i Kushtetutës: "3. Vendimi për të propozuar shtatë (7) nga gjyqtarët, varet nga miratimi i dy të tretave (2/3) të deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë. Vendimi për të propozuar dy (2) gjyqtarët e tjerë, merret me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit, të cilët janë të pranishëm dhe që votojnë, por që mund të bëhet vetëm pas pëlqimit të shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet që janë rezervuar ose garantuar për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë."

83 Fjalia e fundit e dispozitës kushtetuese nga neni 114.1 ["Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese"] i Kushtetutës e bën të qartë se duhet të respektohen parimet e barazisë gjinore me rastin e zgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues. Dispozitat e këtij neni, por as dispozitat e **Ligjin nr. 03/L-121,** nuk bëjnë fjalë në mënyrë të veçantë për sigurimin e mosdiskriminimit në fitimin dhe ushtrimin e funksionit të gjyqtarit kushtetues, apo të pozitave tjera në Gjykatë: **mosdiskriminimi** në çfarëdo baze si një kusht që duhet vënë në jetë në çdo kohë buron nga fakti se kategoria e mosdiskriminimit hyn në vlerat më sublime kushtetuese mbi të cilat qëndron dhe në të cilat bazohet rendi kushtetues i **Republikës së Kosovës**, vlera të cilat i sanksionon neni 7 ["Vlerat"] i Kushtetutës.

84 Neni 65.11 [Kompetencat e Kuvendit] i Kushtetutës: "Kuvendi i Republikës së Kosovës: […] (11) propozon gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese. ; […]"

85 Neni 84. 19 [Kompetencat e Presidentit] i Kushtetutës: "Presidenti i Republikës së Kosovës: […] (19) emëron gjyqtarët për Gjykatën Kushtetuese, me propozimin e Kuvendit. ; […]"

86 Neni 6.6 ["Procedura për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese"] i **Ligjit nr. 03/L-121**: "[…] 6. Procedurën për përcaktimin e listës së ngushtë të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese e fillon Komisioni. Komisioni publikon thirrjen/ftesën në media të shkruara dhe elektronike duke përfshirë edhe ato të cilat kryesisht lexohen nga komunitetet që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës, të Kuvendit, institucioneve gjyqësore, fakulteteve juridike, Odës së Avokatëve, shoqatave të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, partive politike, personave të tjerë relevant juridik dhe individëve që të propozojnë kandidat për zgjedhjen e një apo më shumë gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë ftesa/thirrja). **Një person mund të propozojë veten për kandidat**. […]".

87 Neni 6. 1 ["Procedura për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese"] i **Ligjit nr. 03/L-121**:
"1. Me këtë ligj themelohet Komisioni i posaçëm për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë "Komisioni"). Ky Komision i paraqet Kuvendit listën e ngushtë të kandidatëve të kualifikuar për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, në pajtim me procedurën e përcaktuar në këtë nen . […]"

88 Neni 6. 2 ["Procedura për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese"] i **Ligjit nr. 03/L-121**:
"[...] 2. Komisioni përbëhet nga këta anëtarë:
2.1. Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës apo një anëtar i Kuvendit përfaqësues i deleguar i tij/saj;
2.2. Udhëheqësit e secilit grup parlamentar të Kuvendit të Republikës së Kosovës apo anëtarët
e Kuvendit përfaqësues të deleguar të tyre;
2.3. Kryetari i Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës;
2.4. Avokati i Popullit;
2.5. Përfaqësuesi i Këshillit Konsultativ për Komunitete;
2.6. Përfaqësuesi i Gjykatës Kushtetuese".

kryesisë së Kuvendit, për të ushtruar kryesimin e këtij komisioni. Kjo mundësi delegimi nuk stipulohet për asnjërin prej përbërësve tjerë të komisionit në fjalë.[89] Se kjo është kështu shihet edhe nga fakti se vota e kryetarit të Kuvendit ka fuqi të dyfishtë në rastet kur votat janë baras.[90]

Në rast të ekzistimit të **konfliktit të interesit**, ai duhet të raportohet në Komision.[91] Në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për votim në Kuvend, mosraportimi përbën shkelje të rëndë të **etikës** dhe parimit të barazisë së atyre që kanë konkurruar për gjyqtar kushtetues.[92]

Mandati i gjyqtarëve zgjatë nëntë (9) vjet, pa mundësi riemërimi.[93] Pamundësia e riemërimit përbën një standard të përhapur në shumicën e vendeve evropiane. Ky standard është vënë së pari në demokracitë

---

89 Neni 6.3 ["Procedura për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese"] i **Ligjit nr. 03/L-121**: "[…]3. Komisionin e thërret dhe kryeson Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës apo përfaqësuesi i deleguar i tij/saj. Komisioni ka dy zëvendës kryesues të cilët zgjidhen në mesin e anëtarëve të tij, ku njëri nga ta do të jetë nga radhët e deputetëve të komunitetit tjetër nga komuniteti i kryesuesit. […]"

90 Neni 6.4 ["Procedura për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese"] i **Ligjit nr. 03/L-121**: "[…] 4. Komisioni vendos me shumicën e thjeshtë të votave. Në rast të votimit të barabartë, vota e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës apo përfaqësuesit të tij/saj të deleguar është vendimtare.[…]"

91 Neni 6.5 ["Procedura për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese"] i **Ligjit nr. 03/L-121**: "[…] 5. Në rast se ndonjëri nga anëtaret e Komisionit ka konflikt të interesit në lidhje me rastin, atëherë ai/ajo nuk merr pjesë në punën e Komisionit për atë rast […]."

92 Deri më sot ka pasur vetëm një rast që është raportuar në medie për ekzistimin e konflikt të interesit: kryetarja e Gjykatës, **Arta Rama – Hajrizi**, ka shkelur këtë normë ligjore kur ka lejuar veten e saj që të jetë në komisionin e përzgjedhjes së kandidatëve për propozimin e një gjyqtari kushtetues, i ngelur vakant që nga dorëheqja e gjyqtarit ndërkombëtar **Robert Carolan**, sepse në mesin e konkurrentëve kishte qenë një kushëri i afërt i saj. Si bazë juridike në kuptimin objektiv (të matshëm) për konstatimin e ekzistimit të këtij konflikti të rënd interesi ka shërbyer një vendim i Gjykatës Kushtetuese nga nxjerrja e të cilit ishte përjashtuar znj. **Arta Rama – Hajrizi**, atëherë në cilësinë e gjyqtares, sipas kërkesës së vetë asaj. Kërkesën për përjashtim nga rasti, konform nenit 18. 1. 2 ["Përjashtimi i gjyqtarit"] të **Ligjit nr. 03/L-121,** Gjykata e kishte miratuar më datën 15 prill 2015**.** Si bazë për kërkesën për përjashtim kishte shërbyer fakti se kushëriri i gjyqtares kushtetuese **Arta Rama – Hajrizi** kishte qenë gjyqtar **i Gjykatës Themelore në Mitrovicë** – **Dega në Vushtrri** në rastin që në prill të vitit 2015 ishte në vendosje e sipër në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës. I njëjti gjyqtar që kishte vendosur në Vushtrri, tani **ishte në kuadër të atyre që po konkurronin për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese.** Kjo rrethanë përbën konflikt interesi në kuptim të nenit 18.1.2 si më sipër lidhur me nenin që komentojmë këtu të **Ligjit nr. 03/L-121.** Cf. raportimin e medies kosovare të këtij rasti në: "Kryetarja e Kushtetueses jashtëligjshëm në Komisionin për zgjedhjen e një gjyqtari." **KOHA DITORE**, 12 dhjetor 2017. Në internet: http://www.koha.net/arberi/62886/kryetarja-e-kushtetueses-jashteligjshem-ne-komisionin-per-z gjedhjen-e-nje-gjyqtari/**;** "Kuvendi anulon një konkurs shkaku i shkeljes ligjore të kryetares së Kushtetueses." **KOHA DITORE**, 17 dhjetor 2017. Në internet: http://www.koha.net/ arberi/63102/kuvendi-anulon-nje-konkurs-shkaku-i-shkeljes-ligjore-te-kryetares-se-kushtetueses/ (shikuar në shkurt 2018); Për vendimin nga nxjerrja e të cilit është përjashtuar gjyqtarja **Arta Rama – Hajrizi** në prill të vitit 2015, cf. Paragrafin 17 te *Rastet e bashkuara KI 48/14 dhe KI 49/14. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Komuna e Vushtrrisë. Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktvendimeve të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri: (1) CPonr. 46/14, të 6 marsit 2014, (2) CPonr. 49/14, të 6 marsit 2014, (3) CPonr. 53/14, të 6 marsit 2014, (4) CPonr. 52/14, të 11marsit 2014, (5) CPonr. 54/14, të 11 marsit 2014 dhe të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1369/14, të 27 qershorit 2014*. Me këtë vendim të vetin, Gjykata më shumicë votash ka miratuar kërkesën për përjashtim të gjyqtares **Arta Rama - Hajrizi**, në pajtim dispozitat e sipërcekura të **Ligjit nr. 03/L-121.** Diçka që bjen në sy dhe që është për t'u çuditur lidhet me faktin se ky vendim është nënshkruar nga vetë gjyqtarja e përjashtuar, në cilësinë e kryetares së Gjykatës. Kjo nuk përbën standard kushtetues dhe ligjërisht të pranueshëm. Përkundrazi, kjo përbën një precedent të rrezikshëm që nuk do shumë analizë juridike.
Në një ndër vendimet e para të Gjykatës në vitet e saj formative u pat përjashtuar nga një rast, sipas kërkesës së tij, kryetari i gjeneratës së parë të Gjykatës, autori parë i këtij libri, kurse vendimi përfundimtar është nënshkruar nga zëvendës kryetari i Gjykatës, prof. dr. **Ivan Cukallovic**. Një rast i tillë i njëjtë është paraqitur edhe një herë në vitin 2015 dhe Gjykata ka vepruar në mënyrë te njëjtë: vendimi përfundimtar nuk është nënshkruar nga kryetari i Gjykatës, autori i parë i këtij libri, përjashtimi i të cilit qe kërkuar nga **Avokati i Popullit**. Si në rastin e parë ashtu edhe në të dytin, emri i kryetarit të Gjykatës nuk figuron në përbërjen e Gjykatës sepse nuk ka asnjë logjikë juridike dhe kushtetuese që të jetë ndryshe, nisur nga fakti se ekziston një vendim i Gjykatës për përjashtimin e tij nga vendimmarrja në këto dy raste si më sipër. E njëjta vlen edhe për nënshkrimin, i cili, për pasojë, nuk figuron në rubrikën ku nënshkruan në fund kryetari i Gjykatës. Cf. *Rasti KI 88/10. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Agim Paca kundër Enver Hasanit, ish- Rektor në Universitetin e Prishtinës*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. Ref: RK 77/10. Prishtinë, 22 dhjetor 2010; *Rasti K0 22/15. Vendim. Parashtrues: Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës. Kërkesë për përjashtim të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.: V 791/15. Prishtinë, më 17 prill 2015.

93 Neni 114.2 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] i Kushtetutës: "[...] 2. Gjyqtarët emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Kuvendit, për një mandat nëntëvjeçar, pa mundësi vazhdimi [...]."

tradicionale të **Evropës**, në kohën e ndërtimit të gjykatave të tyre kushtetuese pas **Luftës së Dytë Botërore**.[94] Ai është vënë në jetë përmes dispozitave shprehimore kushtetuese. Kjo më pastaj është bartur edhe në vendet tjera të Evropës, në veçanti pas rënies së komunizmit dhe përqafimit të modelit evropian/kelseniana të gjyqësisë kushtetuese në këto vende. Kosova nuk bën përjashtim në këtë drejtim dhe ndjek modelin e shumicës së vendeve ish-komuniste. Ky përcaktim kushtetues kosovar përfshin edhe mandatet e gjeneratës së parë të gjyqtarëve kushtetues, të cilat janë caktuar me tërheqje të shortit në qershor të vitit 2009. Mbarimi i mandateve të kësaj gjenerate nuk përbën nuk lejon që të njëjtit gjyqtarë të riaplikojnë për pozitën e gjyqtarit kushtetues sepse mandati i mëhershëm me short konsiderohet si mandat i plotë dhe si një pengesë për riemërimin.[95]

Kur një gjyqtari kushtetues i mbaron mandati para mbarimit të mandatit të rregullt, emërimi i gjyqtarit të ri bëhet me mandat të plotë, pa të drejtë rizgjedhjeje.[96] Kjo nënkupton se emërimi para kohe i një gjyqtari kushtetues për vendin e mbetur vakant duhet të bëhet sipas të njëjtës procedurë. Në vendet ish-komuniste, zvarritja e zgjedhjes së gjyqtarëve të rinj me qëllim të plotësimit të vendeve vakante ka qenë fenomen shqetësues dhe mjaft i përhapur. Kjo zvarritje ka ndodhur si pasojë e synimeve të politikës për t'i futur në gjykatë kushtetuese njerëzit me lojalitet politik. Në disa raste, ta zëmë rasti i **Shqipërisë** (1992-1997), **Rusisë** (1995-1999), **Bjellorusisë** (që nga themelimi e deri më sot) etj., politika ka pasur një sukses relativ.[97] Ndër rastet ku politika ka qenë më të suksesshme, gjë që përbën një tragjedi në vete, llogaritet rasti hungarez pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2011. Nga ky vit, **Gjykata Kushtetuese e Hungarisë (GJKHu)**, nga një gjykatë e cila kishte qenë shembull i krejt vendeve ish-komuniste, u kthye në një institucion pa ndikim dhe në një hije të asaj çfarë kishte qenë.[98] Në rastet tjera, ky sukses nuk ka qenë i thellë, përkundër përpjekjeve të mëdha të politikës (ta zëmë, rasti i **Sllovakisë** gjatë kohës së kryeministrit Meciar). Ka pasur vende në të cilat, zvarritja e pafund është zgjedhur duke lejuar gjyqtarët me mandat të skaduar të vazhdojnë punën e tyre si gjyqtarë kushtetues deri në zgjedhjen e gjyqtarëve të rinj. Në rastin e **Kosovës** ka pasur stërzgjatje nga qershori i vitit

---

94 Në **Rusi,** gjyqtarët kushtetues kanë mandat 12 vjet, pa mundësi riemërimi. Kështu është në shumicën e vendeve evropiane. Në një skaj të rrallë gjendet përvoja e Çekisë, ku gjyqtarët kanë të drejtën për riemërim. Cf. Amy J. Weisman, "Separation of Powers in Post-Communist Government: A Constitutional Case Study of the Russian Federation."*American University International Law Review* Vol. 10 Issue 4 (1995) fq. 1365-1398 në fq. 1391, fusnota 164; Ryszard Cholewinski, "The Protection of Human Rights in the New Polish Constitution". *Fordham International Law Journal*. Vol. 22 Issue 2 (1998), fq. -235-291 në fq. 286-287 (autori flet për historinë kushtetuese të vendit në sferën e të drejtave të njeriut dhe në fund për **Tribunalin Kushtetues të Polonisë** (TKPol); ky organ i gjyqësisë kushtetuese sipas të a.q. **Kushtetutës së Vogël** të vitit 1992 dhe Kushtetutës së vitit 1998, aktualisht në fuqi, përbëhet prej 15 anëtarëve, por mandati i tyre është nëntë vjet pa mundësi riemërimi); Rett R. Ludwikowski, "Constitutional Culture of the New East-Central European Democracies". *Georgia Journal of International & Comparative Law*. Vol. 29 No 1 (2000) fq. 1-29 në fq. 24; *Zdeněk Kühn, "The Constitutional Court of the Czech Repoublic". Në* András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* (Cambridge University Press: Cambridge, 2017) *fq. 199-236 në fq. 208.*

95 Secili prej gjyqtarëve vendorë të gjeneratës së parë (mandati i ndërkombëtarëve është vazhduar përmes një rruge tjetër, të cilën e kemi shpjeguar më sipër në seksionin pararendës) e ka tërhequr mandatin e vet të paracaktuar përmes shortit: në një zarf të mbyllur kanë qenë të shkruar mandatet për tri (3), gjashtë (6) dhe nëntë (9) vjet respektivisht. Secili nga gjyqtarët vendor është dashur ta tërheq një zarf të tillë. Kjo teknikë e përcaktimit të kohëzgjatjes së mandatit është parashikuar me nenin 152.2 ["Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetutës"] të Kushtetutës së vitit 2008. Kjo teknikë ka pasur për qëllim ruajtjen e kontinuitetit dhe memories institucionale të Gjykatës. Në të njëjtën kohë është synuar që të ruhet kuorumi për vendimmarrje përmes përtëritjes çdo tri vjet të Gjykatës me nga dy anëtar të rinj. Ky qëllim, megjithatë, nuk është arritur aq sa duhet sepse që nga viti 2012 e tutje Kuvendi mezi po arrin të bëj plotësimin e vendeve vakante të gjyqtarëve. Në disa raste, kjo ngecje në plotësim të vendeve vakante ka zgjatur me vite. Në **Kosovë**, deri më sot, megjithatë, nuk ka ndodhur që të paralizohet puna e Gjykatës, siç ka ndodhur në **Ceki,** ku Gjykata Kushtetuese e këtij vendi ka pësuar humbje të kuorumit të saj. Për rastin e Çekisë, cf. *Zdeněk Kühn, "The Constitutional Court of the Czech Republic", fq. 2008; Për rastet tjera të ngjashme të ngecjeve serioze në punë si pasojë e mungesës së gjyqtarëve kushtetues në trupën plenare gjyqësore, si p.sh. në* ***Hungari*** *dhe* ***Sllovaki****, cf. më shumë në* Zdenk Kühn and Jan Kysela, "Nomination of Constitutional Justices in Post-Communist Countries: Trial, Error, Conflict in the Czech Republic". *European Constitutional Law Review* Volume 2 Issue 02 (June 2006) fq. 183 – 208 në fq. 188.

96 Cf. Neni 114. 4 ["Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese"] i Kushtetutës.

97 Herman Schwartz, *The Struggle for Constitutional Justice in Post-Communist Europe* (The University of Chicago Press: Chicago and London, 2000) fq. 8. 222, 226 & 238.

98 Ngjashëm me rastin e **Hungarisë** ku politika arriti më 2012 t'i fus nën kontroll, përveç gjyqtarëve të **Gjykatës Kushtetuese**, edhe **Bankën Qendrore** e median e vendit, një vit më vonë **Rumunia** gati e pësoi të njëjtin fat. Në rastin rumun, reagimi evropian për fat të mirë qe i shpejt dhe me kohë, i ashpër deri në fund, ashtu që përpjekjet e politikës rumune për ta futur në kontroll **Gjykatën Kushtetuese** dështuan. Cf. "Is Romania Worse Than Hungary?" *The Economist* (OpEd): 17.07.2012. Në internet:http://www.economist.comblogs/easternapproaches/2012/07/rom anian-politics.

2012 deri në qershorin e vitit 2018: në qershorin e vitit 2012 u bë zgjedhja e vetëm njërit prej dy gjyqtarëve sa duheshin zgjedhur për dy vendet e lëna vakante.[99]

Vlen të theksohet se kjo dispozitë kushtetuese dhe të tjerat që nuk lejojnë mundësinë e rikandidimit të serishëm të një gjyqtari pas mbarimit të mandatit, përbën një klauzolë të rëndësishme që ndihmon në ruajtjen e pavarësisë së gjyqtarit kushtetues. Ky konstatim ka shumë arsye të jetë mjaft i qëlluar edhe në rastin e **Kosovës**, nisur nga përvoja e vendeve që kanë përqafuar këtë qasje. Nga përvoja e tillë shihet qartë se pavarësia e gjyqtarëve sigurohet dhe garantohet më shumë në rastet kur gjyqtari kushtetues nuk ka nevojë të vrasë mendjen e vet nëse do të caktohet sërish në postin e njëjtë. Pamundësia e kandidimit të serishëm në literaturë gjerësisht konsiderohet si një kusht shumë i fortë i pavarësisë së gjyqtarit kushtetues.[100] Me këtë duhet të pajtohemi edhe ne. E kundërta e kësaj, sistemi që mundëson ripërtëritjen e mandatit gjyqësor, shihet si një sistem që dëmton potencialisht pavarësinë e gjyqtarit sepse i njëjti person duhet të bëjë koncesione dhe të ketë çdoherë parasysh se çfarë mendon autoriteti emërues (pushteti politik) për punën e mëhershme gjatë mandatit të parë si gjyqtar.[101]

Ky është vetëm njëri nga kushtet sepse ekzistojnë edhe disa kushte të tjera objektive që ndikojnë shumë në pavarësinë e një gjyqtari kushtetues: **kultura dhe përvoja e gjatë në demokraci e një shoqërie luajnë një rol të madh në pavarësinë e gjyqtarëve në përgjithësi, përfshirë gjyqtarët kushtetues**.

Kjo, si më sipër, nënkupton se nuk janë vetëm mënyra e caktimit të gjyqtarëve kushtetues dhe natyra e mandatit të tyre faktorë që garantojnë pavarësinë e një gjyqtari individual. Ky kusht duhet të shihet në lidhshmëri me nivelin kulturor të një shoqërie dhe përvojën në demokraci. Nëse veç duhet bërë zgjidhje në mes të peshës që duhet akorduar këtyre dy faktorëve, atëherë vlen të thuhet se të kaluarës demokratike dhe kohëzgjatjes së saj u duhet dhënë përparësi. Kjo për shkak se, në disa vende evropiane që kanë traditë të gjatë demokratike, gjyqtarët e instancave të larta caktohen nga ekzekutivi, diçka që në vendet ish-komuniste as që mund të imagjinohet. Në këto vende evropiane me traditë të gjatë demokratike, megjithatë, ekziston një pavarësi e fuqishme e gjyqësorit, përfshirë gjyqësorin e nivelit të lartë që kryen funksionin e gjyqësisë kushtetuese.[102]

Një diçka e tillë, siç u tha, nuk mund të ndodhë me vendet ish-komuniste, ku në aspektin formal ekzekutivi nuk ka asnjë ndikim në caktimin e gjyqtarëve, përfshirë gjyqtarët kushtetues, ani se efektivisht ushtron një ndikim të madh. Në këto vende, pavarësia është shumë më e ulët në krahasim me vendet me traditë të madhe demokratike, sado që ekzekutivi nuk ka asnjë rol formal në caktimin e tyre. Për këtë arsye, në vendet me traditë të shkurtër në demokraci kushtetuese, ku bën pjesë **Kosova** dhe vendet ish-komuniste, një sistem i tillë ku ekzekutivi do të kishte ingerenca formale në gjyqësi, përfshirë gjyqësinë kushtetuese, do të përbënte rrënim të pavarësisë së dyjave.[103] Në këtë kontekst duhet parë ndikimin që kanë në pavarësinë e gjyqtarëve modelet e zgjedhjes së tyre, qoftë kur bëhet fjalë për gjyqtarët e rregullt apo për gjyqtarët kushtetues.

---

99 Më gjerësisht, cf. fusnotat nr. 78-79, **supra**, në këtë seksion, si dhe komentet tona që i shoqërojnë.

100 Wojciech Sadurski, *Rights before Courts. A Study of Constitutional Courts in Postcommunist States of Central and Eastern Europe* (Springer: Dordrecht, 2005) fq. 14-15 e tutje (autori mbron tezën se pavarësia e gjyqtarit kushtetues forcohet në vendet që nuk lejojnë riemërimin; sistemi i mosemërimit, i cili sot është i përkrahur në shumicën e vendeve të Evropës dhe më gjerë, thotë ky autor, nuk është vetëpërveti garancion i pavarësisë së një gjyqtari kushtetues: kjo është kështu sepse ka raste kur gjyqtarët kushtetues gjatë mandatit të tyre provojnë të bashkëpunojnë me politikën për t'i siguruar vetes një punë apo pozitë të mirë pas mbarimit të mandatit; sidoqoftë, mosemërimi përbën një faktor të rëndësishëm të pavarësisë së gjyqtarit kushtetues).

101 Në vendet ku lejohet riemërimi, zakonisht mospëlqimi i vendimmarrjes së gjyqtarëve kushtetues gjatë mandatit të tyre të parë ka shërbyer si shkak imediat për mosemërim të tyre të sërishëm. Cf. *Zdeněk Kühn, "The Constitutional Court of the Czech Republic". Në* András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, *fq. 199-236 në fq. 209.*

102 Këtu e kemi fjalën për vendet skandinave, Greqinë, Holandën etj. Cf. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *The Composition of Constitutional Courts*, paragrafi 1.1 ["Systems of Appointment"]; European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Judicial Appointmens*, paragrafët: 5-7.

103 European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Report on the Independence pf the Judicial System. Part I: The Independence of Judges.* Adopted by the Venice Commission at its 82nd Plenary Session (Venice, 12-13 March 2010). **Study No. 494 / 2008. CDL-AD(2010)004**. Original: English. Strasbourg, 16 March 2010. Paragrafi 31 ["3. 3.The appointing and consultative bodies"]. Në internet: http://www.venice.Coe.int/ webforms/documents/CDL-AD(2010)004.aspx (shikuar në prill 2018).

Modelet janë dizajnuar me qëllim që të ndikojnë pozitivisht në proceset e përzgjedhjeve dhe caktimit (emërimit) të gjyqtarëve kushtetues në mënyrë që ato procese mos të preken nga politika. Në literaturë është vërejtur se, megjithatë, në vendet ish-komuniste proceset në fjalë janë prekur nga proceset politike si pasojë e faktit që organet që vendosin, kanë një natyrë të tillë, pa marrë parasysh modelin. Sipas hulumtimeve, ky më pak ka qenë rasti me gjyqësorin e karrierës, gjyqësorin e rregullt, i cili funksionon në baza krejtësisht tjera. Kjo tregon se modelet e kopjuara nga demokracitë tradicionale për përzgjedhjen dhe caktimin (emërimin) e gjyqtarëve kushtetues japin rezultatet krejtësisht të tjera, si pasojë e nivelit kulturor dhe traditës së gjatë në demokraci të këtyre vendeve: caktimi i ish-politikanëve në pozita të gjyqtarëve kushtetues nuk përkthehet në politizim të gjyqësisë kushtetuese, siç ndodh me vendet ish-komuniste.[104]

Zgjidhjet e bëra në Kushtetutë, të operacionalizuara tutje me **Ligjin nr. 03/L-121**, kanë natyrë kryesisht legalistike. Kjo nënkupton se i kushtohet rëndësi kushteve plotësimi i të cilave mund të testohet përmes metodave juridike të vlerësimit që objektivisht mund të matet. Kjo qasje ndjek standardin e vendeve të tjera të botës demokratike që kanë gjykatë të ndarë kushtetuese sipas modelit **evropian/kelsenian**, pa marrë parasysh se cilin sistem të caktimit të gjyqtarëve kushtetues përqafojnë.[105]Kushti primar që gjykatat kushtetuese duhet ta plotësojnë është se

[104] Në këtë kontekst, ta zëmë, **Rumania** ka modelin francez të përzgjedhjes dhe caktimit (emërtimit) të gjyqtarëve kushtetues. Model të njëjtë kanë edhe vendet tjera të demokracive të vjetra evropiane, siç janë **Spanja, Italia** dhe **Austria**. Në këto vende, megjithatë, nuk vjen deri te politizimi i procedurave të përzgjedhjes, caktimit (emrimit) dhe, për pasojë, edhe i vetë gjyqësisë kushtetuese. Cf. për këtë më shumë në artikullin e thellë hulumtues të Zdenk Kühn and Jan Kysela, "Nomination of Constitutional Justices in Post-Communist Countries: Trial, Error, Conflict in the Czech Republic", fq. 183 – 208 në fq. 185-186.

[105] Sikundër mund të vërehet nga shtjellimet si më sipër në këtë seksion, sipas nenit 114.1 ["Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese" të Kushtetutës, tri janë kushtet bazike sa i përket kandidatëve për pozitën e gjyqtarit kushtetues. Ato janë: një, që kandidati për gjyqtar kushtetues të jetë jurist i shquar, dy, që kandidati për gjyqtar kushtetues të ketë personalitet me moralin më të lartë, dhe tre, që kandidati për gjyqtar kushtetues të ketë jo më pak se 10 vjet përvojë pune. Për kushtin e parë dhe të tretë folëm më sipër dhe sërish flasim në vijim të këtij seksioni. Në ndërkohë që dyja këto kushte janë të prekshme dhe të matshme, kushti i dytë përbën një vlerësim moralo-politik të deputetit të Kosovës në kontekstin e klimës së momentit kur votohet për kandidatin apo kandidatët konkret për gjyqtarë kushtetues. Plotësimi i kushtit në fjalë nuk mund të matet me kritere legalistike, por vetëm përmes kritereve vlerësuese që kanë natyrë ekstra legale, përfshirë ato të natyrës politike.

Në nenin 4 ["Kushtet shtesë për emërimin e gjyqtareve'] të **Ligjit nr. 03/L-121** u vunë disa kushte shtesë, të cilat mund të thuhet se mund t'i shërbejnë Kuvendit si një parametër relativisht objektiv për vlerësim të kandidatëve që konkurrojnë për gjyqtarë kushtetues. Këta parametra janë relativisht objektiv në kuptimin juridik sepse me qartë dhe në mënyrë objektive e definojnë se cili duhet të jetë personaliteti i gjyqtarit të ardhshëm kushtetues. Në rend të parë, sipas dispozitës së nenit 4 paragrafi 1.pika 1.3 të **Ligjit nr. 03/L-121** kërkohet që personaliteti kandidatit për gjyqtar të plotësojë në mënyrë kumulative tri kushte: një, të ketë reputacion të shkëlqyeshëm moral, parametër ky i pastër ekstra-legal; dy, të ketë aftësi veprimi; dhe, tre, të mos jetë i dënuar. Këto tri kritere duhet të plotësohen në mënyrë kumulative sepse, po u la që Kuvendi të vlerësoj vetëm në bazë të përshtatshmërisë morale të një kandidati, atëherë pashmangësisht ajo përshtatshmëri do të jetë moralo-politike. Kjo është kështu edhe për faktin se pak ka gjasa që një kandidat i dënuar të jetë me moral të përshtatshëm për një gjykatës kushtetues.

Në vijim si më sipër, siç u tha, megjithatë, ky vlerësim i këtyre tre parametrave si më sipër kryhet përmes votës në Kuvend, kur është fjala për modelin e **Kosovës**, përkatësisht përmes vendimit individual të organit qendror shtetëror që cakton gjyqtarin kushtetues, kur është fjala për modelet tjera të vendimmarrjes në kuadër të modelit **kelsenina/evropian** të gjyqësisë kushtetuese. Në kontekstin kosovar, shikuar në kuptimin e përgjithshëm, gjyqtarët kushtetues kërkohet që të propozohen nga një shumicë e kualifikuar parlamentare, e cila natyrshëm që është shumëfish më e lartë sesa shumica që zakonshëm komandon një qeveri e koalicionit. Propozimi që rrjedh nga Kuvendi, meqë duhet të mbërrijë shkallën prej 2/3 të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, është i prirur të jetë maksimalisht konsensual, në kuptimin që asnjë parti politike (apo as koalicioni që kontrollon qeveria) të mos mund ta votojë e vetme. Në këtë kuptim, propozimi për emërimin e gjyqtarëve kushtetues duhet që të jetë konsensual, dhe, natyrshëm, një vendim i tillë konsiderohet juridikisht si neutral dhe i pakontrollueshëm nga një parti apo koalicion i vetëm. Kjo rrethanë, në thelb, e bërë edhe më të besueshëm konstatimin tonë si më sipër se kushtet nga neni 4 të **Ligjit nr. 03/L-121** duhen plotësuar në mënyrë kumulative sepse ka pak gjasa që të jetë ndryshe meqë kërkohet një shumicë e tillë e kualifikuar e dy të tretave. Kjo, në fakt, përbën një garancion kushtetues që kandidatët e zgjedhur për gjyqtarë kushtetues të jenë figura konsensuale, në kuptimin që një shumicë e kualifikuar parlamentare t'i shohë si të denjë për ta ushtruar këtë funksion jashtë ndikimeve eventuale politike.

Pas marrjes së propozimit të Kuvendit, Presidenti i Republikës **duhet** të bëjë emërimin e gjyqtarëve kushtetues. Pyetje me rëndësi për këtë kontekst është nëse Presidenti i Republikës mund të refuzojë një propozim të Kuvendit? Kushtetuta nuk jep ndonjë përgjigje të qartë për këtë, megjithatë, për aq kohë sa Presidenti i Republikës **vishet me të drejtën e emërimit,** natyrshëm që mund edhe ta ushtroj të drejtën e refuzimit të emërimit të një propozimi të Kuvendit. Në ushtrimin e kësaj të drejte, megjithatë, Presidenti i Republikës duhet të arsyetojë që një nga kushtet e kërkuara nga Kushtetuta për kandidatët për gjyqtar kushtetues nuk është zbatuar. Në të kundërtën, Presidenti është i detyruar ta bëjë emërimin sipas propozimit të Kuvendit. Kjo mundësi për refuzim të emërimit dhënë Presidentit bëhet edhe më e arsyeshme nëse kihet parasysh fakti se propozimet për kandidat nuk vijnë nga një trup profesional, siç është rasti, ta zëmë, me **Këshillin Gjyqësor** që propozon gjyqtarët e gjyqësorit të rregulltë, por nga një organ krejtësisht politik, përfaqësues dhe jo profesional. Por, siç u cek, Presidenti duhet çdo refuzim ta arsyetoj deri në detaje meqë bëhet fjalë për një të drejtë kushtetuese individuale. Kjo nënkupton se çdo vendim i Presidentit për refuzim mund të përfundoj për kontroll gjyqësor të ligjshmërisë së tij sipas rregullave mbi konfliktin administrativ dhe, më pas, në kontroll të kushtetutshmërisë së tij pranë **Gjykatës Kushtetuese** sipas nenit 113.7 të Kushtetutës.

ato duhet të plotësojnë vendet vakante për gjyqtarë nga juristë të shkëlqyeshëm dhe profesionalisht të mirë në çdo lëmi juridike, si dhe në filozofinë e së drejtës. Kosova nuk bën një përjashtim në këtë drejtim sepse, sikundër u vërejt, kërkon që gjyqtarët e saj të jenë juristë të shquar. Ky është një kusht i matshëm me kritere objektive dhe bazohet në punën që ka kryer kandidati në të kaluarën dhe forcën intelektuale që ajo/ai e ka projektuar përmes botimeve nga lëmi juridik, në veçanti nga lëmi e të drejtës publike dhe filozofia se së drejtës. Në praktikë kjo përkthehet si diçka që **profesorëve universitarë** u jep gjasa më të mira për një përfaqësim të madh, në krahasim me kuadrot tjera që nuk vijnë nga jeta universitare. Në këtë përparësi përfshihen edhe punëtorët shkencorë të instituteve të ndryshme hulumtuese dhe shkencore, që kanë botuar gjerësisht në lëmin juridik dhe në sferat tjera të së filozofisë juridike. Kjo qasje ekziston edhe në vendet tjera ish-komuniste të **Evropës**, ku pjesëmarrja në gjyqësinë kushtetuese të profesorëve universitarë paraqitet si mjaft e dukshme.[106]

Në këtë aspekt, kjo praktikë rrjedh nga përvojat që kanë pasur demokracitë tradicionale të **Evropës**: hulumtimet empirike tregojnë se, përveç në rastin e **Francës**,[107] gjykatat kushtetuese kanë një numër të konsiderueshëm të gjyqtarëve që janë juristë dhe vijnë nga profesorati universitar si dhe institutet e ndryshme hulumtuese dhe shkencore. Në përgjithësi, evropianët janë të hapur ndaj këtij profili intelektual të gjyqtarëve kushtetues (p.sh.: **Austria, Gjermania, Italia, Portugalia**, **Spanja etj.**).[108] Kjo gjendje nuk paraqitet e tillë në vendet tjera që kanë gjyqësi kushtetuese, por e cila nuk ushtrohet nga një gjykatë e veçantë dhe e ndarë kushtetuese por nga gjykatat e sistemit të rregullt gjyqësorë. Këto të fundit, sikundër dihet, mund të kenë juridiksion të qartë të përcaktuar me kushtetutë (kryesisht disa vende të **Amerikës Latine** dhe vende të tjera që i takojnë sistemit të së **drejtës së përgjithshme**, për çka kemi folur në kapitujt fillestarë mbi gjyqësinë kushtetuese) apo juridiksion kushtetues të ndërtuar në mënyrë graduale përmes jurisprudencës (rasti i **SHBA**-ve). Profesorët universi-

---

[106] Në raste të rralla në vendet ish-komuniste të Evropës numri i akademikëve në gjykatat kushtetuese ka qenë më i ulët se profesionet tjera. I tillë ka qenë rasti me **Republikën e Çekisë** në vitet e para pas pavarësisë. Kjo situatë në literaturë është shpjeguar me faktin se në tregun e punës nuk ka pasur akademikë të pakomprometuar në kohën e regjimit komunist çekosllovak. Cf. *Zdenek Kühn, "The Constitutional Court of the Czech Republic", fq. 209.*

[107] *Në fakt, pjesëtarët e **KKFr** nuk quhen gjyqtarë por anëtarë. Si të tillë, ata ndahen në anëtarë të rregullt ose **membres** dhe në anëtarë sipas të drejtës së fituar ose **members de droit**. Në grupin e parë hyjnë ish deputetët apo ministrat e drejtësisë, kurse në të dytin sipas pozitës, ish presidentët e **Francës**. Nisur nga ky dallim konceptual, futja e figurave të fuqishme politike në **KKFr** ka kuptim. Rrallë herë akademikët ftohen për të shërbyer si anëtar të tij. Kur kësaj i shtrohet edhe fakti se vetë lindja e Këshillit ka qenë në vijim të sigurimit të fuqisë ekzekutive të gjeneralit **Sharl de Gol (Charles de Gaule**: 1890-1970) ndaj ndërhyrjeve të shpeshta të legjislativit francez, atëherë çdo gjë duket e natyrshme në punën e Këshillit sepse vetë origjina e tij ka qenë për të ruajtur balanset politike në mes të legjislativit dhe ekzekutivit francez. Në publik, anëtarët e **KKFr** cilësohen si **les sages**, ose njerëzit e mençur dhe autoriteti i tyre në publik ngelet i fortë pikërisht si pasojë e bindjes paraprake të njerëzve për misionin kryesisht politik të këtij organi. Cf. Arthur Dyevre,"The French Constitutional Council". Në Cf.* András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, *fq. 323-353 në fq. 329-330.*

[108] Sikundër dihet, në disa vende, si psh. në **Armeni, Francë**, **Lihtenshtajn**, **SHBA**, **Turqi** nuk kërkohet përgatitja juridike si kusht për të qenë gjyqtar kushtetuese (apo gjyqtar i **Gjykatës Supreme** në **SHBA**, e cila ushtron funksionin e gjykatës kushtetuese). I tillë ka qenë rasti edhe me ish-**Jugosllavinë**. Në shumicën e shteteve, ndërkaq, kushti i të qenit jurist kërkohet pashmangësisht. Ky, në fakt, përbën një kusht të cilin që në fillim e ka parashikuar dhe arsyetuar vetë **Hans Kelsen** në shtjellimet e veta teorike në mes të dy luftërave botërore. Që nga ajo kohë, ky kusht nuk është vënë në pikëpyetje asnjëherë në pjesën dërmuese të vendeve që i takojnë modelit **kelsenian/evropian** që nga ajo kohë. Përveç që duhet të jenë jurist, ata duhet të jenë të shquar në lëmin juridik. Cilësimi i juristëve si "të shquar" ka qenë poshtu kusht që vetë **Hans Kelsen** e ka propozuar, duke iu referuar profesorëve universitar. Ky kusht, që nga ajo kohë, ka shërbyer si një cilësi dalluese e fizionomisë së gjykatave kushtetuese në krahasim me gjykatat e rregullta, të cilat janë të stafuar me gjyqtar të karrierës që nuk vijnë nga jeta akademike. Cf. Louis Favoreu & Wanda Mastor, *Les cours constitutionnelles*, fq. 21-22, 36, 50-56; Për rastin e **Austrisë**, cf. Konrad Lachmayer, "The Austrian Constitutional Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 75-114 në fq. 85-87; Për **Gjermaninë**, cf. Michaela Hailbronner and Stefan Martini, "The German Constitutional Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 356-393 në. fq. 365-366; Për rastin e **Italisë**, cf. Tania Groppi and Irene Spingo, "The Constitutional Court of Italy". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 516-559 në fq. 524-525; Për rastin e **Portugalisë**, Louis Favoreu & Wanda Mastor, *Les cours constitutionnelles*, fq. 55; Për rastin e **Spanjës**, cf. Marian Ahumada Ruiz, "The Spanish Constitutional Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 604-640 në fq. 616-617.

tarë nëpër këto vende nuk marrin pjesë në numër të konsiderueshëm në trupën gjyqësore të gjykatës së lartë nacionale që ushtron funksionet e gjykatës kushtetuese.[109]

Këtu hyn edhe **Afrika e Jugut**, e cila ka gjykatë të ndarë kushtetuese me juridiksion të veçantë dhe të ndarë nga sistemi i rregullt gjyqësor, mirëpo i takon sistemit anglo-sakson të së drejtës së përgjithshme. Fakti që në këtë vend ka pak gjyqtarë nga bota akademike shpjegohet me dy rrethana: e para, vendi ka si burime të së drejtës kushtetuese, krahas Kushtetutës së vitit 1996, edhe burime të tjera të së **drejtës së përgjithshme**, siç janë precedentët; dhe, e dyta, akademikët në këtë vend kanë luajtur rol të madh në proceset e demokratizimit dhe hartimit të teksteve të para kushtetuese, por që më pastaj janë tërhequr sepse gjatë kohës së **aparteidit** kanë arsyetuar gjyqësorin e rregullt dhe politikat e tij raciste kundër popullsisë me ngjyrë si shumicë.[110]

T'i kthehemi sërish diskutimit të historikut të gjyqësisë kushtetuese të ish-**vendeve komuniste**, ku bën pjesë edhe **Kosova,** e cila histori tregon se suksesi më i madh i gjyqësisë kushtetuese është arritur në rastet kur gjykatat kushtetuese janë banuar jo nga gjyqtarë të rregullt, avokatë dhe juristë të tjerë teknikë, por nga njerëz të jetës akademike, të papërvojë në interpretimet dogmatike që zhvillohen në gjyqësorin e rregullt.[111] Kjo histori lidhur me strukturën profesionale të gjyqësisë kushtetuese nis me shtjellimin e parë dhe të plotë teorik të arkitektit të saj ideor, **Hans Kelsen**, i cili që në vitin e largët 1928, avokoi fuqishëm për vënien e profesorëve universitarë në pozitat e gjyqtarëve kushtetues. Ai, për më tepër, me këtë rast ka propozuar që fakultetet juridike të bëjnë një komision të përbashkët të veçantë me qëllim të prezantimit të kandidatëve të tyre më të mirë për postin e gjyqtarit kushtetues, ashtu që më pastaj gjykata kushtetuese të ketë të drejtën e **kooptimit** nga mesi i profesorëve të propozuar nga një komision i tillë.[112] Shikuar më thellë, kjo qasje ka kuptim të plotë për dy arsye: e para, profesorët universitarë në parim janë më pak dogmatikë si pasojë e natyrës së punës që kryejnë; dhe,

---

[109] Cf. Për rastin e **Australisë**, cf. Cheryl Saunders and Adrienne Stone, "The Hight Court of Australia" Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 36-74 në fq. 39-40; Për **Brazilin**, cf. Conrado Hubner Mendes, "The Supreme Court of Brazil". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 115-153 në fq. 128-13; Për rastin e **Britanisë së Madhe**, cf. Tamas Gyorfi, "The Supreme Court (House of Lords) of the United Kingdom". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 679-722 në fq.689-691; Për rastin e **Irlandës**, cf. Eoin Carolan, "The Supreme Court of Irland". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 438-470 në. fq. 446-447; për **Izraelin**, cf. Suzie Navot, "The Israeli Supreme Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 471-515 në fq. 478-480; Për rastin e **Kanadasë**, cf. Hugo Cyr and Monica Popescu, "The Supreme Court of Canada". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 154-98 në fq. 167-169; Rasti i **SHBA**-ve, cf. në Howard Schweber and Jennifer L. Brookhart, "The Supreme Court of the United States". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 723-760 në fq. 730-732; Për **Taivanin**, cf. Wen – Chen Chang, "The Constitutional Court of Taiwan". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 641-678 në fq. 647-648 (deri në vitin 1990, pra gjatë kohës së **Luftës së Ftohtë**, akademikët kanë qenë fare pak prezent si gjyqtarë, mirëpo pas këtij viti ka filluar një trend i rritjes së numrit të tyre; një gjë e tillë reflekton traditën konservative taivaneze mbi rolin e madh të gjyqësorit dhe historinë e këtij vendi pas fitimit të komunizmit në **Kinë**, të cilën e kemi treguar në kapitujt tjerë fillestarë të këtij libri kur kemi folur për gjyqësinë kushtetuese në vendet ish-komuniste).

[110] Cf. Christa Rautenbach and Lourens Du Plessis, "Constitutional Court of South Africa". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq.560-603 në fq. 673-576.

[111] Cf. Për një analizë të shkëlqyer të përvojave të të gjitha vendeve ish komuniste, si dhe për rolin dhe pozitën e gjykatave kushtetuese gjatë tranzicionit, përfshirë këtu krahasimin e tyre me vendet e përparuara perëndimore, shih më shumë në: Herman Schwartz, *The Struggle for Constitutional Justice in Post-Communist Europe'*, fq. 1 - 21 dhe 226-248; Levent Gonenc, *Prospects for Constitutionalism in Post-Communist Countries* (Kluwer Law International: The Hague, 2002), në veçanti kapitujt 1 ("Conceptual Framework") dhe 3 ("Constitution-Making"), fq. 3-25 dhe 103-208; Jean-Pierre Massias, *Droit constitutionnel des Etats d'Europe de l' Est*. (2e edtion) (Presses Universitaire de France: Paris, 2008) fq. 13- 63; Luca Mezzeti (ed.), *Sistemi e Modeli di Giustizia Costituzionale*. Tomo I (CEDAM: Padova, 2009) et Tomo II (CEDAM: Padova, 2001), pjesët e autorëve që flasin për vendet ish-komuniste (kapitujt 10, 11, dhe 18 të vëllimit I, dhe kapitulli 5 i vëllimit II).

[112] Cf. fusnota nr. 26, **supra**, në këtë kapitull, si dhe komentet tona që e shoqërojnë. Vlen të theksohet që, megjithatë, **kooptimi** i gjyqtarëve kushtetues nuk përbën një standard në gjyqësinë kushtetuese të modelit **kelsenian/evropian**. Janë të rralla rastet kur kushtetutat parashikojnë këtë institut, siç është rasti me **Kushtetutën e Portugalisë** të vitit 1976, e cila lejon kooptimin e gjyqtarëve nga ana e atyre dhjetë gjyqtarëve që zgjedhen nga **Asambleja e Portugalisë** (paragrafi i parë i nenit 222 të Kushtetutës, i cili normon përbërjen dhe statusin e gjyqtarëve kushtetues). **Portugal's Constitution of 1976 with Amendments through 2005**. Në internet: https://www.constituteproject.org/constitution /Portugal_2005.pdf (shikuar në prill 2018).

e dyta, natyra e dijes kushtetuese dhe e të drejtës publike në përgjithësi i bën profesorët universitarë më të përshtatshëm për këto pozita, nisur nga fakti se mësimi dhe studimi i vazhdueshëm që ata bëjnë, paraqet një barrierë të fuqishme kundër dogmatizmit të vendimmarrjes dhe mendjes së tyre.[113]

Për këtë arsye, në **Kosovë** dhe në modelin **keslenian/evropian** në përgjithësi kërkohet një përvojë, së pakut, prej dhjetë vjetësh, duke i dhënë përparësi profesionit të profesorit universitar: përvoja dhjetë*vjeçare* në mësimdhënie, studime dhe hulumtime mjafton për të tejkaluar retorikën dogmatike që shoqëron sferat tjera të profesionit të juristit. Cilësia sipas së cilës kandidati për gjyqtar duhet të jetë një "jurist i shquar", që e kërkon Kushtetuta[114] dhe që e ka kërkuar i pari i gjyqësisë kushtetuese, **Hans Kelsen**,[115] nënkupton që një kandidat të ketë vlera të larta profesionale në fushën e drejtësisë në përgjithësi. Duhet pasur parasysh që pozita gjyqtar kushtetues, në kuptim të vet rolit të gjyqësisë kushtetuese, nënkupton jurist të shquar, jo thjeshtë në aspektin teknik, siç mund të jenë gjyqtarët dhe avokatët e rëndomtë, por juristë të natyrës filozofike. Duhet thënë këtu që gjyqësia kushtetuese natyrshëm kërkon aftësi juridike jo thjeshtë të nivelit të teknikës së konstruksionit të normës, por edhe të natyrës filozofike dhe prapavijës teorike të normës kushtetuese. Shumica e normave kushtetuese, megjithëse nga jashtë duket se kanë shumë pak kuptim tekstual/teknik, ato referojnë tek koncepte që janë zhvilluar me shekuj si në kuptimin teorik ashtu edhe në atë filozofik, interpretimi i të cilave kërkon aftësi që shkojnë përtej interpretimit teknik të normave juridike. Shikuar në këtë kontekst, koncepti "jurist i shquar" i shkruar në Kushtetutë është referim për tek aftësitë përtej anës teknike të së drejtës, duke përfshirë edhe aspekte teorike dhe filozofike mbi bazën e së cilave janë zhvilluar konceptet kushtetuese, të cilat, megjithatë, mund të duken shumë teknike në shikim të parë. Prandaj, koncepti "jurist i shquar" i shfrytëzuar në këtë normë, dallon thelbësisht nga karakteristika e juristit që kërkohet të ushtrojë profesionin e gjyqtarit të rregullt. Kjo për shkak se, si i tillë, ky koncept ngërthen në vete një pamje shumëfish më komplekse të shkencës juridike dhe filozofisë të së drejtës.

Për të qenë gjyqtar kushtetues, diversiteti etnik, kulturor, gjuhësor dhe tjetër nuk përbën një kriter shprehimor e as ndonjë standard të përqafuar gjerësisht në **Evropë**.[116] Në Kosovë ky nuk është rasti: në Kushtetutë ka gjetur një vend të veçantë respektimi i diversitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe tjetër. Prej nëntë gjyqtarëve që ka Gjykata, dy gjyqtarë propozohen nga shumica e deputetëve të pranishëm, pasi që të kenë marrë pëlqimin e shumicës së deputetëve që mbajnë **vendet që janë të garantuara** (sepse vendet e rezervuara më nuk ekzistojnë që nga fundi i pavarësisë së mbikëqyrur në shtator të vitit 2012) për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë. Kjo dispozitë kushtetuese, në mënyrë efektive detyron Kuvendin që të votojë cilindo kandidatë që plotëson kushtet formale për gjyqtar kushtetues dhe që është rekomanduar nga **Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve në kuptim të nenit 78** (nën 3 &4) [Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve] të Kushtetutës.[117]

Krahas diversitetit etnik, gjuhësor, kulturor dhe tjetër si më sipër, diversitet që mbrohet në mënyrë te veçantë më dispozitat e kapitullit të III-të ["Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre"] të Kushtetutës, në Kosovë një peshë të veçantë ka edhe respektimi i barazisë gjinore. Edhe kjo përbën,

---

[113] Në **Kosovë** nuk kërkohet një moshë e veçantë për të qenë gjyqtar kushtetues. Në disa vende, për të qenë gjyqtarë kushtetues kërkohet një moshë e caktuar ashtu që pa përmbushjen e këtij kushti nuk mund të ushtrohet funksioni i gjyqtarit kushtetues. Cf. Michaela Hailbronner and Stefan Martini, "The German Constitutional Court", fq. 265 (kërkohet mosha 40 vjet, krahas të qenit jurist i diplomuar me një përvojë të gjatë pune); *András Jakab and Johanna Frölich,* "The Constitutional Court of Hungary". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 394-437 në. fq. 405, fusnota nr. 27 (kërkohet mosha 45 vjet, krahas të qenit jurist i diplomuar me një përvojë të gjatë pune).

[114] Neni 114.1 ["Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese"] i Kushtetutës:
"1. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga nëntë (9) gjyqtarë, të cilët do të jenë juristë të shquar dhe personalitete me moralin më të lartë, jo me më pak se dhjetë (10) vjet përvojë profesionale përkatëse. Kualifikimet e tjera përkatëse rregullohen me ligj. Parimet e barazisë gjinore do të respektohen. [...]".

[115] Cf. fusnota nr. **112 & 113**, **supra**, në këtë kapitull, si dhe komentet tona aty.

[116] Zakonisht kjo përbën një kusht në vendet që kanë rregullim shtetëror federative. Cf. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *The Composition of Constitutional Courts,* paragrafet 2.2 dhe 2.3.

[117] Cf. fusnota nr. 82, **supra,** në këtë seksion, si dhe teksti që e shoqëron.

njëjtë si barazia e komuniteteve kosovare, një postulat dhe parim kushtetues që përshkon tërë sistemin kushtetues kosovar dhe ka një rëndësi të posaçme: nuk është vetëm fjalia e fundit e dispozitës së nenit 114.1 të Kushtetutës, por tërë shpirti dhe fryma e rendit kushtetues kosovar bazohet në mosdiskriminim gjinor dhe mbi asnjë bazë tjetër.[118] Sa i përket përfaqësimit regjional të pjesëve të caktuara të **Kosovës**, kjo nuk përbën një kusht për t'u zgjedhur gjyqtar kushtetues.[119]

Deri më tani folëm për zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetues, e cila kryhet nga ana e një organi të jashtëm, **Kuvendi i Kosovës**. Këtu ngelet edhe një çështje tjetër që ka të bëjë me zgjedhjen dhe mandatin kushtetues të anëtarëve të Gjykatës. Fjalën e kemi për kryetarin dhe zëvendëskryetarin e Gjykatës Kushtetuese: neni 114.5 i Kushtetutës përcakton që kryetari dhe zëvendëskryetari i Gjykatës Kushtetuese zgjidhen nga vet gjyqtarët kushtetues, me anë të votimit të fshehtë, për një mandat trevjeçar. Për t'u zgjedhur kryetar dhe zëvendëskryetar kërkohet një shumicë e thjeshtë e votave të trupës gjyqësore. Zgjedhja në funksione drejtuese të Gjykatës, në të dy rastet, nuk mund ta shtyjë mandatin si gjyqtar, sipas të njëjtit paragraf të nenit 114. Në këtë kuptim, Kushtetuta i hap rrugë një lloj autonomie të brendshme të Gjykatës sa i përket zgjedhjes së kryetarit të saj, duke mos lejuar participimin e aktorëve të tjerë shtetërorë në këtë përcaktim të brendshëm të saj.[120] Kjo duhet të shihet si një standard i pavarësisë, meqë nuk lejon hapësirë që emërimi i kryetarit dhe zëvendëskryetarit të bëhet me ndikim nga jashtë. Në kuptim të këtij paragrafi, emërimi i kryetarit dhe të zëvendëskryetarit bëhet me shumicën e votave të gjyqtarëve të Gjykatës.

12.3. Statusi

Në këtë pjesë të këtij kapitulli diskutojmë tri aspekte përbërëse që janë përcaktues thelbësor të statusit të gjykatësve të **GJKRKS**. Ato janë kategoritë si vijon: **papajtueshmëria**, **privilegjet** dhe, në fund, **imunitetet**. Këto tri aspekt janë thelbësore për ruajtjen e pavarësisë objektive dhe integritetin e gjyqtarit kushtetues. Aspektet në fjalë, si të tilla, kanë natyrë institucionale dhe afektojnë pavarësinë e gjyqtarit në përgjithësi, përfshirë gjyqtarin kushtetues. Në ndërkohë që mënyra e zgjedhjes, siç u diskutua më sipër, përbën vetëm një situatë hipotetike që mund të ndikojë **apriori** në vendimmarrjen e ardhshme dhe integritetin e një gjyqtari konkret, këto tri aspekte janë të një natyre tjetër kundrejt ndikimit që ushtrojnë në pavarësinë dhe integritetin e një gjyqtari. Pa sigurimin dhe garantimin e këtyre tri aspekteve

---

118 Cf. fusnota nr. 83, **supra,** në këtë seksion, si dhe teksti që e shoqëron.

119 Në disa vende, në **Austri** ta zëmë, tre nga dymbdhjetë (12) gjyqtarët e **GJKAu** duhet të jenë nga rajonet jashtë **Vjenës**. Kjo, megjithatë, nuk diktohet nga diveristeti etnik, kulturor, gjuhësor dhe tjetër i këtij vendi por nga arsyet pragmatike: në literaturë thuhet se kjo bëhet për të garantuar strukturën federale të **GJKAu** Cf. Konrad Lachmayer, "The Austrian Constitutional Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 86; Vlen të theksohet, megjithatë, se në **Kosovë** përfaqësimi regjional **de facto** përben një cilësi të praktikave të shëmtuara në fitimin dhe ushtrimin e posteve politike, përkatësisht në vënien e kuadrove nëpër vendet udhëheqëse profesionale: kërkimi i njerëzve nga regjioni i njëjtë me ata që janë në pushtet përbën një kusht të heshtur për fitimin dhe ushtrimin e një posti të caktuar. Lojaliteti regjional nuk duhet të jetë kriter as faktik e as ligjor, së paku jo në vendet me rregullim shtetëror unitar siç është **Kosova.**

120 Në këtë drejtim nuk ka një standard stabil dhe të qartë. Përvojat e vendeve lidhur me këtë dallojnë. Në disa vende, kryetarin e zgjedhin organeve tjera kushtetuese (parlamenti ose kryetari i shtetit). Në vendet tjera, zgjedhjen e bëjnë vetë gjyqtarët kushtetues. Mund të thuhet se zgjedhja nga brenda, përkatësisht nga vetë trupa gjyqësore paraqet një rrugë më të qëlluar dhe më të dëshirueshme sepse më shumë ka gjatë të sigurojë pavarësinë e gjyqësisë kushtetuese.
Në grupin e parë hyjnë shtetet si: **Azerbajxhani, Estonia, Gjermania, Lihtenshtajni, Polonia, Zvicra** (parlamenti), **Austria, Çekia, Finlanda, Franca, Japonia, Irlanda, Norvegjia, Kanada, Sllovakia, Spanja** (kryetari i shtetit). Në grupin e dytë, ndërkaq, hyjnë këto vende: **Argjentina, Belgjika, Bullgaria, Danimarka, Gjeorgjia, Hungaria, Islanda, Italia, Latvia, Kroacia, Maqedonia, Portugalia, Rumania, Rusia, Sllovenia, Shqipëria, Turqia, Ukraina**. Zakonisht kërkohet një shumicë absolute, por ka raste kur kërkohen edhe dy të tretat e votave të gjyqtarëve kushtetues (**Portugalia**). Ka raste kur procedura thjeshtëzohet në rast të dështimit të parë, siç është rasti me **Italinë, Portugalinë** dhe **Spanjën**. Në modalitete të çuditshme hyn rasti i **Armenisë,** ku kryetarin e zgjedh parlamenti. Nëse ai dështon ta bëjë një gjë të tillë, atëherë kjo e drejtë i kalon shefit të shtetit. Cf. European Commssion for Democracy Through Law (Venice Commission), *The Composion of Constitutional Courts,* paragrafi 3.1.

si më poshtë, në një mënyrë institucionale, nuk mund të flitet për ekzistimin e një ambienti ku gjyqtari kushtetues ndihet i sigurt për ushtrimin e funksionit. Këtu, pra, flitet për **rrethana objektive**, për pavarësinë e gjyqësisë kushtetuese.

Kjo pavarësi ka disa aspekte: disa syresh kanë të bëjnë me organizimin e gjyqësisë kushtetuese kurse të tjerat në mënyrë të drejtpërdrejtë lidhen me statusin juridik-kushtetues të gjyqtarëve kushtetues. Ka rëndësi që këto aspekte që lidhen me organizimin e Gjykatës dhe statusin e gjyqtarit kushtetues të kenë rrënjë të forta kushtetuese, njëjtë si çështja e caktimit të gjyqtarëve, pra të definohen nga një akt juridik kushtetues ose i barasvlefshëm me të dhe më pastaj të operacionalizohen me ligje dhe rregulla të tjera juridike. Nga analiza komparative del se në demokracitë kushtetuese liberale, të vjetra dhe të reja, kushtetutat nacionale i normojnë bazat themelore të pavarësisë dhe statusit të gjyqtarëve kushtetues, kurse ligjet organike apo ligjet tjera i specifikojnë më tutje normat kushtetuese që garantojnë pavarësinë organizative dhe statusore të gjyqësorit, përfshirë këtu gjyqësorin kushtetues.[121]

Të shohim si duken këto tri aspekte institucionale të statusit të gjyqtarit në kontekstin kosovar të gjyqësisë kushtetuese.

12.3.1. Papajtueshmëria

Dispozitat kushtetuese flasin për kualifikimet dhe cilësitë themelore që duhet t'i posedojnë gjyqtarët kushtetues, për barazinë gjinore si parim kushtetues që duhet të respektohet në çdo moment, duke ia lënë çështjen e kualifikimeve dhe cilësive të tjera shtesë **Ligjit nr. 03/L-121**. Kjo qasje kësisoj nuk përbën zgjidhjen më të mirë sepse, ka shumë rëndësi që kriteret lidhur me kualifikimet themelore, sikur ato që lidhen me papajtueshmërinë **objektive** (funksionale), të përcaktohen me tekstin kushtetues në mënyrë sa më të qartë dhe sa më hollësisht që të jetë e mundur. Sa më shumë që këto aspekte i lihen për rregullim ligjit organik dhe akteve të tjera me fuqi më të ulët se kushtetuta, të cilat normojnë organizimin dhe punën e gjykatës, aq më shumë shtohen gjasat për ndërhyrje të faktorëve ekstra-kushtetues dhe ekstra-ligjorë në vendimmarrjen e gjykatës kushtetuese. Papajtueshmëria **objektive** (funksionale), të cilën e diskutojmë në vijim, bën pjesë në këto kushte thelbësore që do të duhej të ishin të sanksionuara me tekstin kushtetues, jo me ligj.

Në **Kosovë**, megjithatë, ky nuk është rasti: papajtueshmëria **objektive** (funksionale) përcaktohet me **Ligjin nr. 03/L-121,** kurse procedura e përjashtimit për shkak të konfliktit të interesit dhe pengimit të tij në një rast konkret përcaktohet edhe me **RP**. Në rastin e fundit, pra, fjala është për konflikt të interesit të një gjyqtari në raport më një rast konkret dhe përbën një çështje krejtësisht tjetër nga papajtueshmëria **objektive** (funksionale).

Në vijim si më sipër, papajtueshmëria në kuptimin **objektiv** (funksional) përcaktohet dhe normohet me **Ligjin nr. 03/L-121**, jo me **RP**, dhe atë vetëm me një nen të tij. Ai nen është

---

[121] Kjo del nga hulumtimi i **Komisionit të Venecias**, në të cilin në fund jepen tekstet kushtetuese dhe ligjore të secilit vend të hulumtuar, me dispozita konkrete, që sigurojnë parametrat themlorë të statusit të gjyqtarëve kushtetues.Cf. European Commssion for Democracy Through Law (Venice Commission), *The Composion of Constitutional Courts*, shtojca II. ["Questionnaire on the Composition of Constitutional Courts"] & shtojca III. ["Comparative Table of Replies to the Questionaire on the Composition of Constitutional Courts"].
Ka raste kur teksti kushtetues nuk parashikon një gjë të tillë. Ky është rasti me **Holandën**: Kushtetuta e vitit 1814 nuk ka dispozita shprehimore që flasin për pavarësinë gjyqësore. Kjo gjendje, megjithatë, nuk paraqet problem sepse ekzistojnë dy ligje të veçanta që kanë dispozita mbi organizimin e gjyqësorit dhe statusin ligjor të gjyqtarëve, Ligji i vitit 1827 mbi Organizimin e Gjyqësorit dhe Ligji i vitit 1996 mbi Oficerët Gjyqësor. Përveç kësaj, në **Holandë**, sikundër dihet, ekziston një sistem i rreptë monist ku supremacia (epërsia) e të drejtës ndërkombëtare është absolute. Si pasojë e kësaj, roli dhe ndikimi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (**KEDNJ**) ka qenë tejet i madh ashtu që jurisprudence e **Strasburgut** ka gjetur vend të kyç në promovimin e aspekteve organizative dhe statusore të gjyqësorit holandez. Cf. më shumë për këtë në R. de Lange & P.A.M. Mevis, "Constitutional Guarantees for the Independence of the Judiciary" *Electronic Journal of Comparative Law* Vol. 11 No. 1 (May 2007) fq. 1-17.

neni 5 ["Papajtueshmëria e funksionit"], i cili bën fjalë për papajtueshmërinë **objektive** (funksionale) në një mënyrë mjaft të qartë. Nga katër paragrafët e këtij neni,[122] vetëm i treti me radhë mbulon situatat që kanë të bëjnë me kohën para fitimit (pas zgjedhjes në Kuvend, por para emërimit nga Presidenti) të pozitës së gjyqtarit kushtetues.[123] Situatat tjera të përshkruara në tre paragrafët tjerë kanë të bëjnë me kohën e mbajtjes dhe ushtrimit aktiv të funksionit të gjyqtarit kushtetues.

Gjendja e papajtueshmërisë **objektive** (funksionale) duhet t'i referohet një pozite, funksioni apo pune që është aktuale dhe që reflekton konflikt me pozitën e në ardhje apo atë aktuale si gjyqtar kushtetues. Kjo do të thotë se, në parim, pozita, funksioni apo puna që nuk janë aktuale nuk mund të llogariten si një gjendje që e bën të papajtueshëm fitimin e pozitës së gjyqtarit kushtetues, si dhe ushtrimin e tij.[124] Këto pengesa që formojnë papajtueshmërinë kanë të bëjnë si me fazën e fitimit (zgjedhjen dhe emërimin) ashtu edhe me atë të ushtrimit aktiv të postit të gjyqtarit kushtetues. Thënë me fjalë të tjera, neni 5 flet si për papajtueshmërinë me rastin e fitimit të postit (zgjedhjes dhe emërimit) ashtu edhe gjatë kohës së të qenit gjyqtar kushtetues.

Pengesat që formojnë papajtueshmërinë, janë barriera **objektive** që përcaktohen në mënyrë të përgjithshme nga një normë dhe i shërbejnë pavarësisë së gjyqtarit dhe integritetit të tij, duke pasur për qëllim ruajtjen e natyrës së funksionit të gjyqtarit kushtetues. Këtë e ka konstatuar Gjykata në njërin prej vendimeve të saj kur ka qortuar publikisht njërin prej gjyqtarëve të saj që kishte marrë pjesë aktive në një fushatë politike të organizuar nga njëra prej partive, **PDK** (**Partia Demokratike e Kosovës**).[125] Në shqiptimin e kësaj mase ndaj gjyqtarit kushtetues, **Kadri Kryeziu**, Gjykata kishte vënë theksin në arsyetimin e vet në rëndësinë që

---

[122] Neni 5 ["Papajtueshmëria e funksionit"] i **Ligjit nr. 03/L-121:**
"1. Gjatë mandatit të tij gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk ka të drejtë të jetë:
1.1. anëtar i një partie, lëvizje ose çfarëdo organizate tjetër politike;
1.2. anëtar i bordit drejtues të një ndërmarrje publike, shoqërie tregtare ose organizate jo qeveritare;
1.3. anëtar i një sindikate;
2. Përveç ndalesave të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk ka të drejtë të ushtrojë ndonjë detyrë tjetër publike apo profesionale për të cilën shpërblehet me pagesë, përveç ushtrimit të funksionit të ligjëruesit të shkencave juridike në një universitet të akreditуar. Për qëllime të këtij ligji, nuk konsiderohet detyrë publike apo profesionale nëse gjyqtari pa pagesë merret me veprimtari shkencore, apo pa pagesë angazhohet si anëtar në institute ose shoqata të juristëve, në organizata humanitare, kulturore, sportive dhe organizata tjera, përderisa këto aktivitete nuk kanë lidhje me punën e ndonjë partie politike;
[…];
4. Secili gjyqtar ka për detyrë të njoftojë Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese me shkrim për çdo aktivitet që kryen jashtë funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese për të cilën kompensohet me mëditje ose çfarëdo forme tjetër të kompensimit. Në rast se Kryetari i Gjykatës Kushtetuese shpreh kundërshtimin e vet, gjyqtari ka të drejtë të kërkojë që vendimi i Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të rishqyrtohet nga të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese. Vendimi i tillë mund të hidhet poshtë nga shumica e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese."

[123] Neni 5 ["Papajtueshmëria e funksionit"] i **Ligjit nr. 03/L-121:**
"[…] 3. Gjyqtari i propozuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk mund të emërohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës nëse nuk paraqet dëshmi se ka dhënë dorëheqje nga funksionet e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni […]."

[124] **GJKGJe**, si shembull krahasues, theksoi se kandidatura e një anëtari të saj për president të Republikës Federale nuk e diskualifikon atë automatikisht nga ushtrimi i funksionit në Gjykatë Kushtetuese, e as nuk përbën **per** bazë të mjaftueshme për ta vënë në dyshim paanshmërinë e tij. (Vendimi i **GJKGJe** nr. 1BvR 1693/92 i datës 8 shkurt 1994). Teksti i plotë në internet: https://dejure.org/dienste/vernetzung/ rechtsprechung? Gericht = BverfG & Datum= 08.02.1994& Aktenzeichen=1%20BvR%201693%2F92. **Gjykata Kushtetuese e Belgjikës** ka vendosur që pjesëmarrja e një deputeti në elaborimin e një ligji që është kontestuar panë saj, që konsiston në përkrahjen nga ana e gjyqtarit të shumicës parlamentare së cilës i përkiste duke votuar për ligjin dhe kundër amendamenteve të paraqitura nga opozita, nuk është arsyetim objektiv i mjaftueshëm për dyshimet e parashtruesve sa i përket aftësive së tij që si gjyqtar të shqyrtojë paanshmërisht kushtetutshmërinë e ligjit të kontestuar. *Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Belgjikës* nr. 35/94 i datës 10 maj 1994 (atëbotë quhej "Gjykata e Arbitrazhit", emërtim që është ndërruar me amendamentet kushtetuese të vitit 2007). Për përmbledhjen e tekstit të aktgjykimit në fjalë, cf. në *International Conference on "The Influence of the ECHR Case-Law on National Constitutional Jurisprudence"*. Kyiv, Ukraine, 13-16.10.2005. **Extracts from CODICES Database of the Venice Commission.** fq. 55. Në internet: http://www.venice.coe.int/files /courts%20 referring %20to% 20 the% 20 ECHR.pdf (shikuar në mars 2018).

[125] *Rasti KK 124/14. Aktvendim. Hetimi për pretendimet e sjelljes jokushtetuese nga gjyqtari Kadri Kryeziu.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.: 698/14. Prishtinë, më 20 gusht 2014, paragrafi 21: "[…] 21. Gjykata thekson që njëra nga garancitë e pavarësisë së Gjykatës Kushtetuese ndërlidhet me klauzolën e papajtueshmërisë, d.m.th. disa kufizime të caktuara që rrjedhin nga vetë natyra e funksionit kushtetues gjyqësor. Kjo i referohet aktiviteteve jashtëgjyqësore, qofshin ato publike apo private, të cilat në ndonjë mënyrë janë në papajtueshmëri me funksionin e të qenit gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese […]"

ka për pavarësinë e Gjykatës, ruajtja e imazhit të saj në publik dhe respektimin e një baraspeshe në mes të jetës së gjyqtarëve si qytetarë të zakonshëm dhe respektimit nga ana e tyre të kufizimeve për t'u marrë me disa aktivitete që janë në kundërshtim (apo të papajtueshme) me natyrën e gjyqtarit kushtetues.[126] Në arsyetimin e këtij kufizimi, Gjykata me shumë elokuencë është mbështetur në standarde të vendeve perëndimore lidhur me angazhimin dhe aktivitetin politik të gjyqtarëve, si dhe lidhur me aktivitetet tjera të papajtueshme me funksionin e gjyqtarit, përfshirë këtu jo vetëm ata por edhe anëtarët e familjes së tyre.[127]

Në këtë rast Gjykata ka bërë dallimin në mes të pavarësisë së gjyqtarit dhe Gjykatës Kushtetuese, në njërën anë, dhe paanësisë në vendimmarrje të gjyqtarëve kushtetues, në anën tjetër. Në ndërkohë që në rastin e parë flitet për kufizime të përgjithshme dhe parimore që kanë fuqi **objektive** veprimi, si në kohë ashtu dhe në hapësirë, në rastin e dytë bëhet fjalë për paanësinë e gjyqtarit si një gjendje **subjektive** që përcaktohet nga marrëdhënia e saj/tij me rastin apo palët në procedim e sipër. Kjo e dyta rregullohet, në rastin e **Kosovës**, në kuadër të kreut II të **Ligjit nr. 03/L-121** dhe rregullit 2 të **RP** që kanë të bëjnë me procedurën në Gjykatë dhe nuk ka të bëjë fare me natyrën **objektive (funksionale)** të pozitës së gjyqtarit kushtetues, siç është kufizimi që përbën papajtueshmërinë **objektive** (funksionale): përcaktues kryesor për konfliktin e interesit është marrëdhënia konkrete e një gjyqtari me rastin konkret dhe palët tjera në procedurë, pa marrë parasysh nëse gjyqtari kushtetues ka kontribuar apo jo në krijimin e rrethanave të tilla. Me fjalë të tjera, këtu flitet për **konflikt të interesit** të një gjyqtari kushtetues, jo për papajtueshmëri në kuptimin **objektiv** (funksional) në mes të pozitës si gjyqtar kushtetues dhe një pozite tjetër që nuk i shkon pozitës së gjyqtarit kushtetues.

Kjo e dyta mund të lindë si para dhe pas fitimit (zgjedhjes dhe emërimit) të postit të gjyqtarit kushtetues ashtu edhe gjatë kohë së ushtrimit të këtij funksioni. Në fakt, në rastin e **konfliktit të interesit**, fjala është për marrëdhënie **subjektive** në mes të gjyqtarit, rastit dhe palëve, jo domosdo për ndonjë faj apo qëllim të gjyqtarit për ndërtim të një gjendjeje të tillë subjektive që potencialisht rrezikon paanshmërinë e saj/tij në vendimmarrje në një rast që aktualisht pret për t'u zgjidhur në gjykatë. Thënë ndryshe, rasti i dytë i referohet të gjithëve dhe krejt situatave që **objektivisht** janë në kundërshtim me natyrën e funksionit të gjyqtarit kushtetues, kurse i pari ka natyrë krejtësisht **subjektive** dhe lidhet me cilësitë e palës, rastit dhe vetë gjyqtarit si dhe me marrëdhëniet që kanë këto tri aspekte me njëri tjetrin. Në rastin e parë mund të ndodhë

---

[126] Ibid., paragrafi 22:
"[…] Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se gjyqtaret nuk duhet te jene te izoluar nga shoqëria në të ci1ën jetojnë, pasi që sistemi gjyqësor mund të funksionojë si duhet vetëm nëse gjyqtarët janë në kontakt me realitetin. Megjithatë, aktivitetet e tilla mund ta rrezikojnë paanshmërinë e tyre, apo ndonjëherë edhe pavarësinë e tyre. Prandaj, duhet të vendoset një baraspeshë e arsyeshme ndërmjet asaj se sa mund të përfshihen gjyqtarët në shoqëri, si dhe nevojës që ata të jenë dhe të konsiderohen si të pavarur dhe të paanshëm në kryerjen e detyrave të tyre. Në këtë drejtim, në kontekstin e caktuar social dhe në sytë e një vëzhguesi të arsyeshëm e të informuar, duhet të shikohet se a është angazhuar gjyqtari në një aktivitet i cili në mënyrë objektive do të mund ta cenonte pavarësinë apo paanshmërinë e tij. Nëse një gjyqtar është i pasigurt, Gjykata do të duhej t'i siguronte organet apo personat që kanë funksion konsultativ dhe këshillimor, dhe që janë në dispozicion të gjyqtarëve kurdo që ata kanë ndonjë pasiguri në lidhje me atë se a është një aktivitet i caktuar nga sfera private në pajtueshmëri me statusin e tyre si gjyqtar. Më tej, sa i përket pjesëmarrjes së gjyqtarëve në debate publike të një natyre politike, ata nuk do të duhej të ekspozoheshin ndaj sulmeve politike të cilat nuk janë në pajtim me neutralitetin e kërkuar nga gjyqësori në mënyrë që ta ruajnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor. Për këtë arsye, gjyqtarët do të duhej të përmbaheshin nga çfarëdo aktiviteti politik që mund të cenojë pavarësinë e tyre apo që e rrezikon përshtypjen e paanshmërisë së tyre. *(Shih, Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian (KKGJE) Opinioni nr. 3 i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian për dijeni të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në lidhje me parimet dhe rregullat që rregullojnë sjelljen profesionale të gjyqtarëve, e në veçanti me etikën, sjelljen e papajtueshme dhe paanshmërinë, Strasburg, 19 nëntor 2002).* […]."

[127] Ibid., paragrafi 23:
"[…]Në një raport të paraqitur në Konferencën Botërore për Drejtësinë Kushtetuese, në emër të **Gjykatës Supreme të Kanadasë**, gjyqtari **Ian Binnie** thekson: *"Kufizimet ndaj aktiviteteve jashtë-gjyqësore të një natyre politike janë të rrepta - gjyqtarët e kanë të ndaluar të angazhohen në aktivitete politike partizane gjatë mandatit të tyre. Ata nuk duhet të jenë anëtarë të ndonjë partie politike, të marrin pjesë në tubime politike, të kontribuojnë në fushata, të marrin pjesë në diskutime politike në publik, apo të nënshkruajnë peticione. Për më tepër, edhe pse bashkëshortët / bashkëshortet dhe anëtarët e tjerë të familjes së një gjyqtari kanë të drejtë të marrin pjesë në politike, ata duhet të jenë të ndërgjegjshëm për ndikimin që aktivitetet e tyre politike mund të kenë në perceptimin e paanshmërisë së gjyqtarit. Në fund, nga gjyqtaret pritet që ta diskualifikojnë vetveten kur besojnë se një person i arsyeshëm, me gjykim të drejtë, dhe i informuar do të mund të mendonte në mënyrë të arsyeshme se gjyqtari do të ishte në konflikt interesi." (Shih, Pavarësia Gjyqësore në Kanada, e paraqitur nga gjyqtari Ian Binnie, në emër të Gjykatës Supreme të Kanadasë).* […]."

që gjyqtari fare nuk ka faj apo nuk ka kontribuuar aspak në ndërtimin e pengesës së tillë **subjektive** për të marrë pjesë në gjykimin e një rasti, siç janë rrethanat e afërsisë familjare apo tjetër, pjesëmarrja në vendosje në një shkallë tjetër për çështjen që gjendet në Gjykatën Kushtetuese dhe kështu me radhë. Në rastin e dytë, ndërkaq, bëhet fjalë për rrethanat **objektive** që lidhen me papajtueshmërinë **objektive** (funksionale) të gjyqtarit kushtetues dhe një veprimtari apo aktivitet tjetër. Cenimi i rregullave për papajtueshmërinë **objektive** (funksionale), ndërkaq, mund të jetë shkak për ndërtimin e pengesave subjektive, përkatësisht të situatave të konfliktit personal të interesit me rastin dhe palët. I tillë ka qenë rasti i përjashtimit për kohë të pacaktuar të gjyqtarit **Kadri Kryeziu**, i diskutuar më sipër, përkatësisht i përjashtimit të tij për kohë të pacaktuar në të gjitha rastet që iniciohen, **inter alia**, nga Presidenti i Republikës se Kosovës, Kuvendi, Qeveria, Avokati i Popullit dhe komunat.[128]

Në vijim të diskutimit si më sipër, në kufizimet që përbëjnë papajtueshmërinë **objektive** (funksionale) dhe që kanë të bëjnë me natyrën e funksionit të gjyqtarit kushtetues hyjnë ato që kanë të bëjnë me aspektet dhe rrethanat politike. Kjo i referohet si fitimit (zgjedhjes dhe emërimit) ashtu edhe mbajtjes dhe ushtrimit aktiv të funksionit të gjyqtarit kushtetues. Sa i përket rastit të parë, zgjedhjes dhe emërimit, si pengesë për t'u zgjedhur apo për të qenë gjyqtar kushtetues, shikuar në aspektin komparativ, përbën e kaluara politike e kandidatit apo angazhimi i saj/tij politik. Në **Kosovë**, angazhimi politik në të kaluarën nuk përbën një pengesë formale-juridike:[129] një rrethanë e tillë përbën barrierë dhe formon papajtueshmëri absolute vetëm gjatë kohës sa ajo/ai është gjyqtar kushtetues. Kjo u diskutua më sipër kur treguar për rastin e gjyqtarit **Kadri Kryeziu**.

Nga jurisprudenca komparative rrjedh se caktimi i ish-politikanëve është më i rrallë dhe paraqet një problem serioz. Këtu kemi parasysh në rend të parë vendet e sistemit **evropian/kelsenian**.[130] Kjo nuk duket të jetë kështu

---

128 Rasti KK 124/14. Aktvendim. Pika III e pjesës operative:
"[…] Gjykata Kushtetuese, në përputhje me rregullin 6 të Kodit të mirësjelljes, në përputhje me nenin 11.1.1 të Ligjit dhe me rregullin 12.1 (a), (e) dhe (g) të Rregullores së punës dhe pas shqyrtimit të pretendimeve dhe përgjigjeve të gjyqtarit Kryeziu, njëzëri: VENDOS
"[…]III. TË PËRJASHTOJË gjyqtarin **Kadri Kryeziu** nga pjesëmarrja në seancat shqyrtuese për të gjitha kërkesat e ardhshme të Gjykatës Kushtetuese ku përfshihen partitë politike apo individët në parti politike apo nga çdo rast tjetër që ka kontekst politik, ku, *inter alia,* një palë mund të paraqitet para Gjykatës, siç është: Presidenti i Republikës së Kosovës, Kuvendi, Qeveria, Avokati i Popullit dhe komunat."

129 Në vetë biografinë e ish-gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, **Kadri Kryeziu**, thuhet se ka qenë funksionar i lartë i dy partive politike: nga viti 1991-200, anëtarë i kryesisë së PPK ("Partia Parlamentare e Kosovës") kurse nga viti 200-2009, anëtar i kryesisë së **AAK** ("Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës"). Në internet: http://gjk-ks.org/judges/prof-dr-ass-kadri-kryeziu/ (shikuar në mars 2018). Ngjashëm është edhe rasti me gjyqtaren aktuale, **Selvete Gërxhaliu**, e cila ka qenë kandidate për deputete e **LDK**-së ("Lidhja Demokratike e Kosovës"). Cf. KMDLNJ: Presidente, mos e dekreto Selvete Gërxhaliu – Krasniqin. **ZERI** 03 dhjetor 2015. Në internet: http://zeri.info/aktuale/65353/kmdlnj-presidente-mos-e-dekreto-selvete-gerxhaliu-krasniqin/ (shikuar në prill 2018).

130 Konrad Lachmayer, "The Austrian Constitutional Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 85-86 (ku autori spjegon se në **Austri** janë kufizimet e njëjta sikur në rastiun e **Kosovës**, mirëpo tregon se të qenit anëtar i një partie politike nuk përbën një pengesë për të qenë gjyqtar aktiv, gjë është situatë pak interesante); *Zdeněk Kühn, "The Constitutional Court of the Czech Republic". Në* András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, f*q. 199-236 në fq. 208-210* (ku autori shpjegon se ish-politikanë në Çeki janë nominuar në Gjykatë Kushtetuese, si pasojë e faktit se ekziston një sistem amerikan i nominimit ku presidenti emëron gjyqtarët me aprovimin e Senatit); Arthur Dyevre, "The French Constitutional Council", fq. 329 (ku autori tregon për ndarjen e anëtarëve të **Këshillit Kushtetues të Francës** në anëtar dhe gjyqtarë: të parët janë zakonisht ish deputetë apo ministra qeveritar); Michaela Hailbronner and Stefan Martini, "The German Constitutional Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* fq. 365 (ku autori tregon se kanë qenë shumë të rralla rastet e emërimit për gjyqtarë kushtetuese në Gjermani të ish-politikanëve; autori përmend si rast të fundi ish kryeministrin e land-it të Saar); *András Jakab and Johanna Frölich,* "The Constitutional Court of Hungary". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 405 (ku autori tregon se zgjedhja e anëtarve të **Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë** ka qenë çdoherë një proces shumë i politizuar, por jo vetë anëtarët e saj: ata profesor universitar që kanë qenë të njërës anë politike, nuk janë zgjedhur sepse çdoherë është kërkuar konsensusi i opozitës dhe pozitës për shkak të shumicës së lartë të kualifikuar që kërkohet për zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetuese në **Hungari)**; Tania Groppi and Irene Spingo, "The Constitutional Court of Italy". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 525(ku autori thekson se gjyqtarët e **Gjykatës Kushtetuese të Italisë** janë njerëz me ekspertizë të lartë në lëmin e drejtësisë dhe me shumë pak përvojë politike apo fare të papërvojë në politikë); Marian Ahumada Ruiz, "The Spanish Constitutional Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 617 (ku autori tregon se sistemi i papajtueshmërive pengon anëtarësimin në Gjykatë Kushtetuese të Spanjës të njerëzve me angazhim aktiv në politikë, mirëpo në të kaluarën ka pasur raste kur ish-politikanët janë zgjedhur gjyqtar kushtetues).

në vendet tjera që nuk i takojnë këtij sistemi.[131] Në rastin e Kosovës gjendja paraqitet si më e ndërmjetme dhe nuk mund të shpjegohet vetëm me praktikat dhe zgjedhjet kushtetuese të njërit prej dy grupimeve të vendeve si më sipër. Kjo shpjegon arsyen pse angazhimi politik dhe angazhimi tjetër publik përmendet menjëherë në fillim të paragrafit të parë të nenit 5 të **Ligjit nr. 03/L-121** që diskuton papajtueshmërinë. Ky paragraf p**ërmend** punët dhe angazhimet që një gjyqtar nuk mund t'i kryejë dhe postet që nuk mund t'i mbajë.[132] Këto ndalesa vlejnë edhe për anëtarët që janë kandidatë për gjyqtarë kushtetues.[133] Kjo nënkupton se asnjë nga këto angazhime dhe aktivitete nuk guxon të ushtrohet apo të kryhet nga kandidatët që synojnë të jenë gjyqtar kushtetues. Ky aspekt i papajtueshmërisë ashpërsohet edhe më shumë kur bëhet fjalë për gjyqtarët kushtetues aktivë: ajo/ai nuk guxon asnjëherë të ushtrojë apo të kryejë punë dhe aktivitete nga paragrafi i parë i nenit 5 si më sipër **Ligjit nr. 03/L-121**, përkatësisht nuk mund të jetë anëtar i një partie, lëvizje ose çfarëdo organizate tjetër politike, anëtar i bordit drejtues të një ndërmarrje publike, shoqërie tregtare ose organizate jo qeveritare dhe, në fund, nuk guxon të jetë anëtar i një sindikate. E thënë me fjalë të tjera, ajo/ai nuk guxon të marrë pjesë nëpër aktivitete të asnjërit prej organizmave politikë, menaxherialë dhe sindikalë.[134]

---

131 Në vendet që nuk i takojnë modelit **kelsenian/evropian**, kjo nuk përbën ndonjë problem të veçantë: ish-funksionarë politik apo njerëz që kanë shërbyer në poste politike caktohen gjyqtar të gjykatave të larta që ushtrojnë funksionet e gjykatës kushtetuese: për rastin e **Australisë**, cf. Cheryl Saunders and Adrienne Stoner, "The Hight Court of Australia". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* fq. 39-40 (ku autori tregon se që nga viti 1975 janë caktuar 13 gjyqtar me prejardhje politike); për rastin e **Brazilit**, cf. Conrado Hubner Mendes, "The Supreme Federal Tribunal of Brasil". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 128-131 (ku autori sqaron se gjyqtarët e **Tribunalit Federal të Brazilit** mund të jenë një përzierje e atyre që kanë origjinë të fuqishme politike me profesionet tjera si avokat apo prokurorë publik); për rastin e **Britanisë së Madhe**, cf. Tamas Gyorfi, "The Supreme Court (House of Lords) of the United Kingdom". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 690-691 (ku autori shpjegon se politizimi i gjyqësisë së lartë në këtë vend ka pasur një traditë para Luftës së Dytë Botërore, kurse pas kësaj kohe ka nisur një proces i depolitizimit të saj); për rastin e **Kanadasë**, cf. Hugo Cyr and Monica Popescu, "The Supreme Court of Canada". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 167-169 (ku autori tregon që kryeministri dhe ministri i drejtësisë caktojnë gjyqtarët e **Gjykatës Supreme të Kanadasë**, kurse zgjedhja e politikanëve të dikurshëm ka përbërë një praktikë të përhapur në vitit '50 të shekullit të kaluar, kurse dekadave e të fundit kjo praktikë i ka lëshuar rrugë profesionalizmit dhe juristëve të karrierës gjyqësore si dhe akademikëve); për rastin e **Irlandës**, cf. Eoin Carolan, "The Supreme Court of Irland". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 446 (ku autori shpjegon se gjyqtarët caktohen nga qeveria dhe kjo përbën një bazë që në publik të ekzistoj perceptimi i politizimit të gjyqtarëve; pikërisht për këtë arsye, në këtë vend ka nisur iniciativa për ndryshim të këtij sistemi të caktimit të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, e cila kryen funksione të gjyqësisë kushtetues enë të njetën kohë); për **Izraelin**, cf. Suzie Navot, "The Israeli Supreme Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 478-480 (ku autorja shpjegon se në këtë vend ekziston një Komitet për Caktimin e Gjyqtarëve, i cili me një shumicë votash i zgjedh gjyqtarët e këtij vendi, përfshirë ata të Gjykatës Supreme; ky organ përbëhet nga nëntë vetë dhe pesë nga ata duhet të vijnë nga organet jopolitike, kryesisht nga gjyqësori dhe komuniteti legal; kjo gjykatë kryen funksione kushtetuese dhe çdoherë ka ndejtur larg politikës); për rastin e **SHBA**-ve, cf. në Howard Schweber and Jennifer L. Brookhart, "The Supreme Court of the United States". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 730-732 (ku autori shpjegon faktin që kushtetuta nuk kërkon përgatitjen prej juristi për të qenë gjyqtar i Gjykatës Supreme, mirë në praktikë kjo është si një rregull e pashkruar; nga gjysmën e dytë të shekullit XX, thekson autori, ka pasur një tendencë të fuqishme për rritjen e ndikimeve ideologjike të senatorëve amerikan me rastin e caktimit të gjyqtarëve të kësaj gjykate); për **Taivanin**, cf. Wen – Chen Chang, "The Constitutional Court of Taiwan". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 647-648 (ku autori shpjegon se nuk ka politikan në radhët e gjyqtarëve, por vetëm përfaqësues të komunitetit të gjyqësorit të rregullt ose profesor universiteti).

132 Cf. fusnota nr. 122, **supra**, në këtë kapitull, si dhe komentet tona që e shoqërojnë. Në **Austri**, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese po ashtu nuk mund të jetë anëtar në organizmat si më sipër politik dhe jo politik. Atje, megjithatë. gjyqtari ka të drejtë që të japë këshilla me pagesë për çështjet kushtetuese që janë në zhvillim e sipër në Gjykatë. Nga vitit 2015, në **Austri** është futur rregulli që gjyqtarët duhet t'i bëjnë publike anëtarësimet e tyre në pozita menaxhuese dhe nëpër borde të ndryshme kurse ende nuk ka ndalesa për konflikt interesi në dhënien e këshillave juridike kompanive private. Kjo do të thotë se në sferën private ende nuk ka nevojë të bëhet transparente pozitat në ekonomi private apo lidhur me dhënien e ndonjë këshille kompanive private. Cf. Konrad Lachmayer, "The Austrian Constitutional Court" Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 87.

133 Cf. fusnota nr. 123, **supra**, në këtë kapitull, si dhe komentet tona që e shoqërojnë

134 Në përvojën e **Gjykatës Kushtetuese,** për fat të keq, është regjistruar vetëm një rast i tillë, kur një gjyqtar kushtetues, gjyqtari **Kadri Kryeziu**, pat marrë pjesë aktive në fushatën zgjedhore të njërës prej partive politike kosovare, **PDK** (**Partia Demokratike e Kosovës**), gjatë zgjedhjeve të përgjithshme të qershorit 2014. Në një mbledhje administrative, Gjykata ka trajtuar raportin e komisionit të caktuar nga kryetari i saj, **Enver Hasani**, me qëllim të konstatimit të përgjegjësisë. Komisioni pat gjetur se një sjellje e tillë e gjyqtarit në fjalë përbën një shkelje të detyrave të punës dhe është e papajtueshme me funksionin e gjyqtarit kushtetues. Pas shumë dilemave nëse gjyqtari **Kadri Kryeziu** duhej të shkarkohej, më në fund Gjykata ka vendosur për një masë më të butë – masën e qortimit. Cf. fusnotat nr. 125-129, **supra**, në këtë kapitull, si dhe komentet tona lidhur me këtë. Cf. po ashtu edhe fusnotën nr. **17** në kapitullin **11** të këtij libri.

Në paragrafin e dytë të nenit të njëjtë përcaktohen ndalesat tjera që formojnë papajtueshmëri absolute: gjyqtari i **Gjykatës Kushtetuese** nuk mund të mbajë asnjë post tjetër publik apo profesional për të cilën shpërblehet me pagesë, përveç ushtrimit të funksionit të ligjëruesit të shkencave juridike në një universitet të akreditуar.[135] Kjo nënkupton se puna si gjyqtar është marrëdhënie me orar të plotë e punë primare dhe, për pasojë, çdo punë në universitet mund të jetë vetëm dytësore. E theksojmë këtë sepse ka vende kur puna në gjykatë nuk është punë primare, por punë shtesë që mund të ushtrohet krahas një profesioni tjetër që ka natyrë primare (cilido qoftë ai profesion).[136] Kjo nuk është kështu në Kosovë.

Në fjalinë e fundit të paragrafit të dytë, si më sipër, përcaktohet se çka konsiderohet post publik apo profesional: nuk konsiderohet post publik apo profesional nëse gjyqtari pa pagesë merret me veprimtari shkencore, apo pa pagesë angazhohet si anëtar në institute ose shoqata të juristëve, në organizata humanitare, kulturore, sportive dhe organizata tjera, përderisa këto aktivitete nuk kanë lidhje me punën e ndonjë partie politike. Kjo dispozitë është futur duke e pasur parasysh se në Kosovë ka pak kuadro universitare dhe shkencore, ashtu që, nëse do të futej si konflikt interesi një kategori e tillë e kuadrove, atëherë do të dobësohej niveli profesional i Gjykatës.

Rastet kur njëri prej gjyqtarëve të Gjykatës është duke ushtruar ndonjë post tjetër publik ose profesional për të cilën shpërblehet me pagesë pas marrjes së detyrës së gjyqtarit, duhet të merren vesh përmes vetëdeklarimit të saj/tij: gjyqtari menjëherë, pa shtyrje, duhet ta informojë kryetarin e Gjykatës për një gjë të tillë. Kryetari, ndërkaq, ka të drejtë të vendosë për të ndaluar ushtrimin e një posti apo funksioni të tillë. Nëse gjyqtari mendon se kryetari ka qenë i anshëm dhe nuk ka vlerësuar si duhet aktivitetin e tij jashtëgjyqësor që e ushtron, atëherë shumica e gjyqtarëve marrin vendim përfundimtar rreth asaj se kush ka të drejtë. Kjo parashikohet në paragrafin e katërt dhe të fundit të nenit 5 të **Ligjit nr. 03/L-121**, i cili në të njëjtën kohë është i heshtur rreth asaj nëse dikush tjetër, përveç gjyqtarit që ka konflikt të supozuar të interesit, mund të ngre çështjen e prezencës së rrethanës nga ky paragraf si më sipër. Pra, nuk është e qartë nëse dikush tjetër nga Gjykata apo jashtë saj mund të denoncojë për papajtueshmëri të supozuar të dy gjendjeve në të cilat ndodhet ajo/ai si gjyqtar kushtetues. Nuk shohim këtu që ka ndonjë pengesë për një gjë të tillë, pra, për denoncim nga çdokush, brenda dhe jashtë Gjykatës, të papajtueshmërisë së supozuar të dy gjendjeve në të cilat gjendet një gjyqtar kushtetues. Në një rast të tillë, nëse vërtetohet që ekziston papajtueshmëri dhe gjyqtari e ka fshehur një rrethanë të tillë, atëherë ajo/ai do të gjendet jo vetëm në shkelje të **Kodit të Etikës,**[137] por edhe të shkeljes së rëndë të detyrave të saj/tij si gjyqtar kushtetues.[138] Një rrethanë e tillë, e konstatuar nga Gjykata në përbërje të plotë, përbën arsye të mjaftueshme për të propozuar shkarkimin e gjyqtarit të tillë kushtetues në

---

135 Cf. fusnota nr. 122, **supra**, në këtë kapitull, si dhe komentet tona që e shoqërojnë.

136 Kështu është në **Austri**, një traditë që ka ngelë nga koha kur **GJKAu** nuk ka pasur shumë punë. Kjo vlen vetëm për gjyqtarët, jo edhe për kryetarin dhe zëvendës kryetarin e saj: këta duhet të jenë në marrëdhënie të plotë punë në Gjykatë. Nuk ka rëndësi këtu nëse flitet për profesorë universitarë apo për avokatë apo ndonjë profesion tjetër: gjyqtarët kushtetues në këtë vend mund të ushtrojnë në të njëjtën kohë edhe profesionin e avokatit, noterit, profesorit universitar apo tjetër profesion të ngjashëm me këto. Cf. Konrad Lachmayer, "The Austrian Constitutional Court." Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 86-87.

137 **Gjykata Kushtetuese** ka miratuar një kodin të mirësjelljes për gjyqtarë më 19 qershor 2013. Në internet: http://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2017/11/gjkkkodiimiresjelljespergjyqtareshq.pdf (shikuar në prill 2018).

138 Neni 10 ["Detyrat e gjyqtarëve"] i **Ligjit nr. 03/L-121**:
"1. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese kanë për detyrë të ushtrojnë me ndërgjegje dhe në mënyrë të paanshme funksionin e gjyqtarit dhe të vendosin sipas bindjes së lirë në pajtim me Kushtetutën.
2. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese kanë për detyrë të ruajnë reputacionin dhe dinjitetin e Gjykatës Kushtetuese.
3. Secili gjyqtar ka për detyrë të marrë pjesë në punën dhe procesin e vendimmarrjes së Gjykatës, si dhe të kryejë punët tjera të caktuara me ligj dhe me rregulloren e punës".

kuptim të nenit 118 të Kushtetutës së vitit 2008[139] lidhur me nenin 9.1 (5) të **Ligjit nr. 03/L-121.**[140] Kjo bazë për përfundim të mandatit para kohe, si dhe procedura për vënien në jetë të saj, specifikohen më tutje në një mënyrë të detajuar në rregullin 6 të **RP**.[141]

Para caktimit si gjyqtar, përkatësisht para dhënies së betimit para **Presidentit të Republikës** dhe marrjes së dekretit për emërim, kandidati i zgjedhur nga Kuvendi duhet të japë dorëheqje nga postet (funksionet) e përcaktuara nga dy paragrafët e parë të nenit 5 të **Ligjit nr. 03/L-121.** Kështu thuhet në paragrafin e tretë të këtij ligji.[142] Dorëheqja i paraqitet **Presidentit të Republikës.** Cila duhet të jetë arsyeja që dorëheqja i paraqitet një organi pranë të cilit ende kandidati për gjyqtar nuk e ka dhënë betimin, pra ende nuk është bërë gjyqtar kushtetues në kuptimin formal? Gjyqtari nuk është gjyqtar pa betim: ajo/ai paraqet vetëm një kandidat për gjyqtar deri në momentin e dhënies së betimit. Vetëm **dekretimi**, i njohur në diskursin publik dhe laik si **emërimi**, përbën aktin juridik të vlefshëm për nisjen e punës së gjyqtarit të **Gjykatës Kushtetuese**. Arsyeja për formulim të tillë dispozitës së paragrafit të tretë të nenit 5 si më sipër është fare e thjeshtë: **Presidenti i Republikës përfaqëson unitetin juridik-kushtetues të** popullit kosovar, prandaj betimi jepet para saj/tij si simbolikë e ushtrimit të funksionit të ruajtjes së funksionit dhe stabilitetit të institucioneve shtetërore, si njëra prej formave të manifestimit të unitetit të populli. E thënë me fjalë të tjera, betimi para saj/tij e bën atë simbol të këtij uniteti të popullit të Kosovës, i cili duhet të shprehet, manifestohet dhe ushtrohet nga ana e saj/tij me rastin e nxjerrjes së çdo akti juridik, ndërmarrjes së çfarëdo veprimi si dhe në çdo paraqitje publike. Kjo përbën ***raison d'être*** të dispozitës si më sipër që thotë se asaj/atij duhet t'i drejtohet dorëheqja si më sipër e kandidatëve për gjyqtar kushtetues. Me pranimin e këtyre dorëheqjeve, **Presidenti**

---

[139] Neni 118 ["Shkarkimi "] i Kushtetutës: "Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese mund të shkarkohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës me propozimin e dy të tretave (2/3) të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, vetëm për kryerjen e krimeve të rënda ose **për mospërfillje të rëndë të detyrave**."

[140] Neni 9. 1.5 ["Përfundimi i mandatit para kohës"] **Ligjit nr. 03/L-121:**
"1. Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese i pushon mandati para skadimit të kohës së rregullt për të cilën është zgjedhur në rast të:
1.1. dorëheqjes;
1.2. vdekjes;
1.3. humbjes së përhershme të aftësisë së veprimit të konstatuar nga gjykata kompetente;
1.4. sëmundjes apo problemeve të tjera shëndetësore, të cilat e bëjnë të pamundur ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese;
1.5. **shkarkimit sipas nenit 118 të Kushtetutës**."

[141] Rregulli 6 ["Procedurat për shkarkim"] i **RP** (miratuar më 23 nëntor 2001):
"1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të shkarkohet vetëm në këto raste:
në rast të kryerjes së ndonjë krimi të rëndë, **në rast të mospërfilljes së rëndë të detyrave të punës**,
në rast të humbjes së përhershme të aftësisë për të vepruar, ose
në rast të sëmundjes a të ndonjë problemi tjetër shëndetësor, që e bën të pamundur ushtrimin e përgjegjësive dhe të funksionit të gjyqtarit.
2. Shkarkimi mund të propozohet nëpërmjet një dokumenti të shkruar, ku përshkruhet baza për shkarkim, dhe i cili nënshkruhet nga një ose më shumë gjyqtarë dhe i dorëzohet Kryetarit. Dokumentet që përmbajnë çfarëdo fakti të rëndësishëm, duhet t'i bashkëngjiten propozimit për shkarkim. Propozimi për shkarkim duhet të jetë konfidencial dhe të gjithë gjyqtarët duhet të njoftohen me të sa më shpejt që të jetë e mundur.
3. Kryetari njofton me shkrim gjyqtarin e propozuar për shkarkim mbi bazën e propozimit për shkarkim dhe i jep gjyqtarit përkatës propozimin e shkruar dhe të gjitha faktet relevante të bashkëngjitura. Në rast se Kryetari propozohet për shkarkim, Zëvendëskryetari i bën njoftimin e njëjtë Kryetarit.
4. Gjyqtarët mbajnë takim konfidencial, për të diskutuar shkarkimin e propozuar. Gjyqtari i propozuar për shkarkim ka të drejtë të jetë i pranishëm në takimin konfidencial dhe ka të drejtë të përgjigjet ndaj propozimit për shkarkim, të japë ose të paraqesë shpjegime ose informacione dhe t'u përgjigjet pyetjeve të gjyqtarëve.
5. Gjyqtarët mbajnë një takim tjetër konfidencial nga i cili përjashtohet gjyqtari i propozuar për shkarkim. Në këtë takim, gjyqtarët përcaktojnë nëse do t'ia propozojnë këtë shkarkim Presidentit të Republikës së Kosovës. Kryetari i Gjykatës e kryeson këtë takim dhe diskutimet e gjyqtarëve mbesin konfidenciale. Për t'i propozuar shkarkimin Presidentit të Republikës së Kosovës, propozimi për shkarkim duhet të votohet nga 2/3 e të gjithë gjyqtarëve të mbetur të Gjykatës. Gjyqtarët duhet të kenë të drejtë, po ashtu nëpërmjet shumicës prej 2/3, të vendosin sanksione ose masa disiplinore që janë më pak të ashpra sesa shkarkimi, në rast se rrethanat e lejojnë një gjë të tillë".

[142] Cf. fusnota nr. 123, **supra**, në këtë kapitull, si dhe komentet tona që e shoqërojnë.

i Republikës vepron brenda rolit të saj/tij kushtetues si përfaqësues simbolik i unitetit juridiko-kushtetues të krejt kosovarëve.

12.3.2. Privilegjet (rroga, mëditjet, protokolli, makina, banesa etj.)

Privilegjet e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese paraqesin tërësinë e masave ligjore dhe kushteve të tjera për të lehtësuar ushtrimin e profesionit të gjyqtarit kushtetues, të cilat nuk i gëzojnë të tjerët. Ato paraqesin masa ligjore me qëllim të krijimit të lehtësirave për gjyqtarët kushtetues në mënyrë që ato/ata të ushtrojnë në mënyrë efektive funksionin e gjyqtarit kushtetues. Për dallim nga imunitetet, për të cilat flasim në vijim, privilegjet nuk janë të domosdoshme: edhe pa ekzistimin e tyre gjyqtarët kushtetues mund të ushtrojnë funksionet e tyre. Thënë me fjalë të tjera, privilegjet vetëm sa lehtësojnë punën e gjyqtarëve kushtetues, kurse imunitetet përbëjnë një **condictio sine qua non** për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit kushtetues. Në grupin e privilegjeve hyjnë jo vetëm **paga** dhe statuset tjera sociale, siç janë **sigurimi shëndetësor** dhe sigurimet tjera që në disa vende iu njihen gjyqtarëve kushtetues,[143] **por edhe lehtësira të tjera që i krijohen një gjyqtari kushtetues për t'ia dhënë mundësinë për të pasur një status dinjitoz në shoqëri me qëllim të sigurimit dhe forcimit të pavarësisë dhe ruajtjes së integritetit të saj/tij.** Këto janë masa institucionale që një shoqëri i ndërmerr me qëllim të krijimit dhe sigurimit të disa lehtësirave në dobi të gjyqtarëve kushtetues në mënyrë që posti i gjyqtarit kushtetues dhe ushtrimi i tij të gëzojnë një status shoqëror sa më dinjitoz.

Në **Kosovë**, vetëm në **RP** ka dispozita mbi lehtësirat në Gjykatën Kushtetuese. Kjo do të thotë se nuk bëhet fjalë për lehtësira në kuptim të ushtrimit të funksionit të saj/tij si gjyqtar kushtetues, por për gjëra krejtësisht të brendshme që kanë të bëjnë me punën e gjyqtarëve gjatë vendimmarrjes.[144] Fjalën e kemi për dispozitat e rregullit 4 ["Përparësia e gjyqtarëve"] të **RP**: asnjë dispozitë e këtij rregulli nuk ka të bëj me çështjen e privilegjeve në kuptimin që po flasim, përkatësisht në kuptim të **lehtësirave institucionale** që u ofrohen gjyqtarëve kushtetues dhe Gjykatës me qëllim të sigurimit të ushtrimit efektiv dhe me *efiçencë* të madhe të detyrave të tyre kushtetuese dhe ligjore, si dhe të detyrave që burojnë nga normat etike.[145]

Krejt ajo çfarë mund të thuhet në kuptimin institucional, ndërkaq, ka të bëjë me deduksionet që mund të nxirren në bazë të analizës së ligjeve kosovare, përfshirë **Ligjin nr. 03/L-121**, të cilat flasin për buxhetin, rrogat, protokollin e shtetit, statusin e funksionarëve publik pas mbarimit

---

[143] Në **Kosovë** ky nuk është rasti: gjyqtarët e **Gjykatës Kushtetuese** nuk kanë privilegje sa i përket sigurimit shëndetësor, çështjes banesore apo privilegje të tjera të ngjashme. Në kohën e mandatit të parë (2009-2012), Gjykata Kushtetues ka kompensuar tre gjyqtarët kushtetues që kanë udhëtuar nga komuna e Prizrenit, në shumën prej 200 eurove të qirasë mujore për secilin. Fjala është për gjyqtarët: **Alltay Surroi**, **Ivan Cukallovic** dhe **Kadri Kryeziu**. Ky kompensim ka zgjatur deri në fund të mandatit të tyre. Kontratat për qiranë e tyre si dhe vendimi administrativ i Gjykatës Kushtetuese për dhënien e këtij kompensimi gjenden në arkivin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.
Pra këtu nuk flasim për privilegjet e gjyqtarëve në kuptimin amerikan, si mbrojtje e tyre nga dhënia e dëshmive, deklaratave apo çdo korrespondencë tjetër në të cilën kanë marrë pjesë në seancë gjatë një gjykimi konkret si gjyqtarë. Cf. për këtë më shumë në Kevin C. Milne, "The Doctrine Of Judicial Privilege: The Historical And Constitutional Basis Supporting A Privilege For The Federal Judiciary" *Washington and Lee Law Review* Vol. 44 No. 1 (1987) fq. 213-235.

[144] Kjo do të thotë se privilegjet tjera normohen me ligje të veçanta, siç janë çështja e pagave të gjyqtarëve, që normohet me **Ligjin nr. 03/L-121**, në ndërkohë që çështja e sigurimit social dhe shëndetësor ngelet në tërësi prerogativë e ligjeve të përgjithshme.

[145] Rregulli 4 ["Përparësia e gjyqtarëve"] i Rregullores së Punës (miratuar më 23 nëntor 2010):
"1. Gjykata përbëhet nga nëntë gjyqtarë, të emëruar në pajtim me nenin 114 të Kushtetutës dhe në pajtim me nenin 6 e me nenin 7 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.
2. Përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë Rregullore të punës, gjyqtarët kanë status të barabartë në ushtrimin e përgjegjësive të tyre, pavarësisht moshës, rendit të emërimit, kohëzgjatjes së shërbimit, ose kohëzgjatjes së mandatit.
3. Me rastin e përcaktimit të rendit të votimit, gjyqtarët votojnë me përparësi, sipas datës dhe sipas kohës së fillimit të mandatit të tyre: ata që janë emëruar më së voni, votojnë së pari. Nëse gjyqtarët janë emëruar në të njëjtën kohë, atëherë ata votojnë me radhë sipas alfabetit.
4. Me rastin e përcaktimit ose të zëvendësimit të gjyqtarëve raportues dhe të kryesuesve të kolegjeve shqyrtuese, përparësia e gjyqtarëve përcaktohet nëpërmjet sistemit të tërheqjes së shortit dhe të emërimit të gjyqtarit përkatës nga Kryetari […]."

të mandatit të tyre si dhe për çështjet tjera lidhur me këtë. Këtyre analizave iu kthehemi në rreshtat vijues.

Ligji nr. 03/L-121 rregullon në mënyrë të veçantë çështjen e buxhetit[146] dhe pagat e gjyqtarëve kushtetues.[147] Për rrogat flasim në vijim.[148] Në këtë drejtim, për nga natyra, ky ligj është **lex specialis**, që d.m.th. se çdo ka fuqi juridike mbi çdo normë tjetër ligjore, përveç normave që kanë natyrë të vetekzekutueshme dhe që kanë hyrë në rendin juridik kosovar përmes ratifikimit, përfshirë këtu ligjet e nxjerra nga Kuvendi në vijim të vënies në jetë të një detyrimi ndërkombëtar të Kosovës përmes ratifikimit të tyre në Kuvend.

Neni 14 që flet për buxhetin, sikundër u pa, ka tre paragrafë. Paragrafi i parë e bën të qartë se buxheti i Gjykatës është pjesë e buxhetit të **Republikës së Kosovës**. Me këtë i jepet një dimension i fortë shtetëror gjyqësisë kushtetuese kosovare. Kjo është në pajtim me fizionominë e Gjykatës Kushtetuese, e cila modelohet sipas llojit **kelsenian/evropian**. Si e tillë, gjyqësia kushtetuese paraqitet si njëri prej pushteteve të krijuara ***(pouvoir constitué),*** që buron nga Kushtetuta, por që si fizionomi më tutje normohet edhe përmes ligjeve dhe akteve të tjera të përgjithshme, të nxjerra nga Kuvendi dhe vetë Gjykata Kushtetuese. Në kuadër të akteve të nxjerra nga Kuvendi, **Ligji nr. 03/L-121** zë një vend të veçantë: neni 2.1 ["Organizimi i punës së Gjykatës Kushtetuese"] e bën edhe më të qartë përcaktimin kushtetues nga neni 115.1 i Kushtetutës.[149] Në ndërkohë që neni 115.1 formon një bazë të fortë kushtetuese sa i përket autonomisë së brendshme të Gjykatës, si në vendimmarrje ashtu dhe në marrëdhëniet e saj me jashtë, përfshirë këtu pavarësinë e plotë organizative, neni 2.1 i **Ligji nr. 03/L-121** e operacionalizon dhe specifikon më tutje këtë dispozitë kushtetuese kur thekson se "Gjykata Kushtetuese gëzon pavarësi organizative, administrative e financiare për realizimin e detyrave të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës ("Kushtetutën") dhe me ligj."

Pavarësia e parë nënkupton që struktura e brendshme e Gjykatës në tërësi vendoset dhe përcaktohet nga gjyqtarët kushtetues. Pavarësia e dytë konsiston në menaxhimin autonom të Gjykatës, pa ndërhyrje nga jashtë dhe pa miratim të vendimeve të saj menaxheriale nga ndonjë autoritet i jashtëm. E fundit, pavarësia e tretë, nënkupton në rend të parë pavarësinë në përpilimin dhe menaxhimin autonom të buxhetit. Kjo theksohet qartë në paragrafin e dytë të nenit 2 të ligjit si më sipër.[150] Sa i përket auditimit të buxhetit të Gjykatës, aty vlejnë rregullat e njëjta si për çdo agjenci tjetër buxhetore, gjë që përcaktohet qartë me paragrafin e tretë të nenit 14 të sipërcekur të **Ligjit nr. 03/L-121**. Këto modalitete të pavarësisë së Gjykatës dhe të autonomisë së saj në çështjet e brendshme, në vendimmarrje (në çështjet juridiksionale dhe ato administrative) dhe në çështjet të tjera, burojnë drejtpërdrejt nga dallimet strukturore dhe funksionit që shkojnë me natyrën e gjyqësisë kushtetuese.

---

146 Neni 14 ["Buxheti"] i **Ligjit nr. 03/L-121**:
"1. Gjykata Kushtetuese financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës.
2. Pavarësisht nga dispozitat e ligjeve tjera, Gjykata Kushtetuese përgatit propozimin e buxhetit të saj vjetor dhe i'a dërgon propozimin e tillë për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës. As Qeveria apo ndonjë organizatë tjetër buxhetore nuk ka të drejtë të ndryshojë ose në çfarëdo mënyre tjetër të modifikojë ose të ndikojë në propozimin e buxhetit të përgatitur nga Gjykata Kushtetuese. Buxheti i propozuar nga Gjykata Kushtetuese përfshihet në tërësi në propozimin për Buxhetin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës që i paraqitet Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratim.
3. Gjykata Kushtetuese menaxhon në mënyrë të pavarur buxhetin e saj dhe i nënshtrohet auditimit të brendshëm dhe si dhe auditimit të jashtëm nga Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës."

147 Neni 15 ["Pagat e Gjyqtareve"] i **Ligjit nr. 03/L-121**:
"Paga e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese është 1.3 herë sa ajo e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës."

148 Cf. fusnotat nr. 153 & 154, **infra,** si dhe komentet tona që e shoqërojnë.

149 Neni 115.1 [Organizimi i Gjykatës Kushtetuese] i Kushtetutës:
"1. Gjykata Kushtetuese përcakton organizimin e vet të brendshëm, rregulloren e punës, proceset e vendimmarrjes dhe çështje të tjera organizative në pajtim me ligjin. […]".

150 Neni 2.2 ["Organizimi i punës së Gjykatës Kushtetuese"] i Ligjit nr. 03/L-121:
"[…] 2. Gjykata Kushtetuese përcakton organizimin e vet të brendshëm, rregulloren e punës, proceset e vendimmarrjes dhe çështje të tjera organizative në pajtim me ligjin".

Këto tri segmente të autonomisë dhe pavarësisë së Gjykatës përbëjnë thelbin e garancioneve kushtetuese dhe ligjore mbi **pavarësisë institucionale**. Këto garancione japin përgjigje në tri pyetje: e para, si planifikohen dhe alokohen burimet për Gjykatën; *e dyta*, nga kush menaxhohen burimet e Gjykatës; dhe, e treta, kush është përgjegjës për mënyrën dhe qëllimet e përdorimit të mjeteve të alokuara. Në tri rastet, përgjigja është e qartë: vetë Gjykata, pa asnjë ndërhyrje nga jashtë. Në ndërkohë që juridiksioni dhe pamundësia e mandatit të dytë të gjyqtarëve kushtetues përbëjnë dy aspekte me rëndësi për pavarësinë e **Gjykatës Kushtetuese**, të cilat janë të saktësuara qartësisht me Kushtetutën e vitit 2008, segmentet si më sipër lidhur me autonominë dhe pavarësinë e saj i referohen garancioneve të pavarësisë së institucionale. Kjo pavarësi institucionale, e shtjelluar si më sipër dhe e marrë si tërësi, përbën një mekanizëm vetimunizues për organizimin, jetën dhe punën e **Gjykatës Kushtetuese**. Përmes këtyre garancioneve vetimunizuese, kushtetuese e ligjore, krijohet mundësia reale për largim dhe mbyllje të saj ndaj çdo ndikimi nga jashtë në çështjet si vijon:

- vendimmarrjen lidhur me organizimin e brendshëm strukturor (organogrami), menaxhimin dhe vendimmarrjen në lëmin juridiksional, gjithnjë në funksion të qëllimit të kryerjes sa më efektive të detyrave kushtetuese nga neni 112 dhe 113 i Kushtetutës; dhe
- në buxhetim sipas vlerësimeve të saj autonome, pa asnjë ndërhyrje nga jashtë, duke ia lënë ligjit special kosovar mbi auditimin e financave publike kompetencat lidhur me mbikëqyrjen e shpenzimit të mjeteve financiare dhe burimeve tjera të alokuara sipas kërkesës së vetë Gjykatës.

Kjo, si më sipër, nënkupton dy gjëra: një, duhet të ekzistojnë çdoherë burimet e mjaftueshme, të vëna në dispozicion për punën e Gjykatës; dhe, dy, në interaksionin e Gjykatës me strukturat tjera të pushtetit shtetëror (ekzekutivin, legjislativin dhe gjyqësorin), në asnjë mënyrë nuk duhet të kompromentohet pavarësia institucionale e Gjykatës përmes formave të presionit, kontrollit politik dhe kontrollit tjetër sa i përket buxhetit dhe planifikimit të nevojave të brendshme të Gjykatës. Në vitin 2010, në kohën sa autori i parë i këtyre rreshtave ka qenë kryetar i Gjykatës, ka pasur përpjekje serioze për shantazh nga **Komisioni për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Kosovës** për ta detyruar atë për t'u paraqitur për raportim pranë këtij komisioni, siç veprojnë njësitë tjera buxhetore që përfaqësojnë tri pushtetet e ndara në Kosovë. Kjo përpjekje është një shkelje flagrante e autonomisë institucionale të Gjykatës, përshkruar si më sipër.[151] U mor vesh, një "ftesë" e tillë për raportim nuk është pranuar nga autori i parë i këtij libri, ashtu që buxheti i Gjykatës për vitin 2010, u pat miratuar në tërësi sipas kërkesave të Kushtetutës dhe **Ligjit nr. 03/L-121**.[152]

Sa i përket **pagave** të gjyqtarëve kushtetues, Kushtetuta është e heshtur dhe nuk flet për një gjë të tillë.[153] Këtë e bën **Ligji nr. 03/L-121**. Çështja e pagave gjendet e normuar në kuadër të kreut të parë që flet mbi organizimin e Gjykatës Kushtetuese, në vetëm një nen, nenin e sipërcekur

---

[151] Ndryshe do të ishte situate sikur ftesa të kishte qenë për pjesëmarrje në Kuvendin e Kosovës, me qëllim të sqarimit të draft-buxhetit të propozuar nga vetë Gjykata Kushtetuese: një pjesëmarrje e tillë me qëllim të mbrojtjes para deputetëve të popullit të pozicionit autonom të gjykatave kushtetuese rekomandohet nga Komisioni i Venecias. Cf. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *The Compilation of Venice Commission Opinions, Reports and Studies on Constitutional Justice (Updated*). Strasbourg, 18 December 2017.**CDLPI(2017)008**. Original: English, paragrafi 4.7. Në internet: http://www.venice.coe.int/ webforms/docume nts/?pdf=CDL-PI(2017)008-e (shikuar në prtill 2018).

[152] "Hasani e kishte paralajmëruar presidentin Sejdiu se do të përfundonte në Kushtetuese". Në internet: http:// archive.koha.net/?id=&l=150512 (shikuar në mars 2018).

[153] Sipas **Komisionit të Venecias**, pagat e gjyqtarëve duhet të jenë stabile dhe te mos ndryshohen. Ato mund të ndryshohen në situatat e krizës së dukshme ekonomike, pra jo në situatat e stabilitetit në vend. Çdo ndryshim i papritur i **pagave** të gjyqtarëve mund të ndikoj në pavarësinë e gjyqësorit, përfshirë gjyqësinë kushtetuese. Niveli i pagave duhet të bazohet, gjithnjë sipas **Komisionit të Venecias**, profesionin dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve dhe të jenë të mjaftueshme për t'i mbrojtur gjyqtarët nga sfidat dhe tundimet për të ndikuar vendimmarrjen e tyre. Cf. *Visit to the Judicial Yuan, Taipei, 10 November 2015. Presentation by Mr Schnutz Dürr.* Në internet: https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-JU-PV(2015)003-e (shikuar në prill 2018) fq. 22-23.

15. Dispozita e këtij neni ka karakter të dispozitës speciale kundrejt çdo dispozite tjetër ligjore që normon financat publike në Kosovë.[154]

Sa i përket protokollit dhe rangut protokollar të gjyqtarëve dhe kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, në tërësi vlejnë rregullat e **Ligjit Nr. 03/L-132 për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës** të datës 16 prill 2009.[155] **N**ë fillim, në dispozitën e nenit 1 që rregullon fushëveprimtarinë e **Zyrës së Protokollit** të Shtetit që gjendet në kuadër të **MPJ** të Republikës së Kosovës nuk përfshihet Gjykata Kushtetuese. Ky nen përcakton si organe që kjo zyrë ka për detyrë të përkujdeset për Presidentin, Kryetarin e Kuvendit, Kryeministrin dhe Ministrin e Punëve të Jashtme. Për titullarët tjerë të institucioneve të larta shtetërore, ky nen flet vetëm sa i përket bashkërendimit të veprimtarisë protokollare të kësaj zyre me zyrat e tyre protokollare. Më vonë, megjithatë, kur përcakton përparësitë e rangjeve zyrtare në nenin 41, **Ligji Nr. 03/L-132** e ven kryetarin e Gjykatës Kushtetuese në grupin e parë, në një rang me Presidentin dhe ish-Presidentin, Kryetarin e Kuvendit dhe Kryeministrin.[156] Në grupin e dytë të rangjeve i futë gjyqtarët kushtetues, në rang me kryetarin e **Gjykatës Supreme** dhe zyrtarët tjerë shtetërorë të rangut të njëjtë.[157] Sa i përket përparësisë së personave "ish" apo të atyre që kanë dalë në pension,

---

154 Kjo qasje që privilegjon **pagat** dhe statusin material të gjyqtarëve kushtetues, përkatësisht të gjyqtarëve të gjykatave të barasvlefshme me gjykata kushtetuese ekziston edhe në vendet tjera, si në vendet ish-komuniste ashtu dhe në vendet e demokracive tradicionale. Jo vetëm kaq! Përtej kontinentit evropian, në sistemet anglo-saksone vërehet se gjyqtarët e gjykatave të barasvlefshme me gjykatat kushtetuese kanë një tretman special sa i përket të ardhurave të tyre, gjë që i dallon dukshëm nga pagat dhe statusi material i funksionarëve të tjerë shtetëror. Lidhur me vendet e sistemit të sistemit të së **drejtës civile-kontinentale**, cf. si në vijim: për **Austrinë,** Konrad Lachmayer, "The Austrian Constitutional Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 88; për Ç**ekinë**, *Zdeněk Kühn, "The Constitutional Court of the Czech Republic".* Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning,fq. 211; për **Francën**,* Arthur Dyevre, "The French Constitutional Council". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 332; për **Gjermaninë**, Michaela Hailbronner and Stefan Martini, "The German Constitutional Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 366; për **Hungarinë**, *András Jakab and Johanna Frölich,* "The Constitutional Court of Hungary" Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 406; për **Italinë**, Tania Groppi and Irene Spingo, "The Constitutional Court of Italy". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 525-526; për **Spanjën**, Marian Ahumada Ruiz, "The Spanish Constitutional Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 619; Lidhur me vendet e sistemit të së **drejtës së përgjithshme**, cf. si në vijim: për **Afrikën e Jugut**autenbach and Lourens du Plessis, "Constitutional Court of South Africa". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 560-603, në fq. 576; për **Australinë**, Cheryl Saunders and Adrienne Stoner, "The Hight Court of Australia". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 42; për **Brazilin,** Conrado Hubner Mendes, "The Supreme Federal Tribunal of Brasil". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 131; për **Britaninë e Madhe**, Tamas Gyorfi, "The Supreme Court (House of Lords) of the United Kingdom". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 691; për **Kanadanë**, Hugo Cyr and Monica Popescu, "The Supreme Court of Canada". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 169; për **Irlandën**, Eoin Carolan, "The Supreme Court of Irland". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 448-449; për **Izraelin**, Suzie Navot, "The Israeli Supreme Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*,fq. 481.

155 **Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës**. Prishtinë: Viti IV/ Nr. 53/01 qershor 2009.

156 Neni 41.1 ["Radha e përparësisë së rangjeve zyrtare"] **i Ligjit Nr. 03/L-132:**
"1. Në Republikën e Kosovës, përparësia e rangjeve zyrtare ndahet në tre grupe kryesore:
1.1. **Grupi I:** Presidenti, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese dhe ish Presidentët. […]".

157 Cf. Neni 41.1. 2 ["Radha e përparësisë së rangjeve zyrtare"] **i Ligjit Nr. 03/L-132:**
"[…]1.2.**Grupi II:** Nënkryetarët e Kuvendit, Zëvendëskryeministrat, Ministrat e Qeverisë sipas listës së dekretimit, Ambasadorët e huaj, Kryetarët e Grupeve Parlamentare, Kryetarët e Komisioneve Parlamentare, Deputetët, Ambasadorët e Republikës së Kosovës në detyrë, Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, Kryetari i Gjykatës Supreme, Kryetari i Kryeqytetit, Avokati i Popullit, Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Guvernatori i Bankës Qendrore, Prokurori i përgjithshëm i Republikës së Kosovës, Komandanti i Përgjithshëm i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Drejtori i Policisë së Kosovës, Drejtori i AIK, Kryetarët e Bashkësive Fetare: Islame, Katolike dhe Ortodokse, të ngarkuarit me Punë në Republikën e Kosovës, Kryetarët e Komunave, Këshilltarët e parë Politikë të Presidentit dhe të Kryeministrit, Rektori i Universitetit Publik, Ushtarak me gradën Gjeneral, Sekretari i Përhershëm i Presidencës, Kuvendit dhe Zyrës së Kryeministrit dhe këshilltarët e parë të Ministrave.
1.3. **Grupi III:** Kryesuesit e Kuvendeve Komunale, Sekretarët e Përhershëm të Ministrive, Drejtorët e Agjencioneve dhe Instituteve në nivel vendi, Kryetarët e Gjykatave të Qarkut, Prokurorët Publik të Qarkut, Drejtori i Muzeut, Drejtori i Arkivit, Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës, Kryetari i Odës Ekonomike, Drejtorët e Drejtorive në Kuvendet Komunale, Kryetarët e Partive joparlamentare, Këshilltarët e Kuvendeve Komunal dhe drejtuesit e Organizatave Joqeveritare."

Ligjit Nr. 03/L-132 përdorë si pikë referimi përparësinë sipas rangut që kanë ata që janë aktualisht në detyrë.[158]

Sa i përket mëditjeve, gjyqtarët kushtetues marrin mëditjes sipas dispozitave ligjore që vlejnë për të gjithë zyrtarët shtetëror të rangut të njëjtë.[159]

Në vijim të diskutimit për statusin shoqëror të gjyqtarëve të Gjykatës, vlen të theksohet në këtë vend se gjatë mandatit si kryetar i parë i saj, autori i parë, përmes zyrës së protokollit në Gjykatës çdoherë ka dërguar për vizita kortezie gjyqtarët dhe kryetarët e huaj vetëm tek Presidenti dhe te Kryetari i Kuvendit, asnjëherë te shefi i ekzekutivit kosovar. Kjo qasje është përqafuar për shkak të respektit pakusht ndaj përfaqësuesi të sovranit kosovar, **Kuvendit të Kosovës**, dhe simbolit të unitetit popullor, **Presidentit të Kosovës**. Po ashtu, në ceremonitë e vitit gjyqësor kushtetues, si dhe në ceremonitë tjera të **Gjykatës Kushtetuese** nuk janë ftuar asnjëherë zyrtarët e ekzekutivit kosovar. Po ashtu, as fotografia e **Presidentit të Kosovës**, e cila sipas ligjit duhet të vihet nëpër institucionet republikane,[160] nuk është vënë në hapësirat e Gjykatës. Kjo sepse një gjë e tillë është objektivisht e papajtueshme me natyrën e gjyqësisë kushtetuese të modelit **kelsenian/evropian**, të cilit i takon **Kosova**, ku **Shefi i Shtetit** paraqitet si një ndër palët e autorizuara procedurale me status të privilegjuar (d.m.th. që nuk ka nevojë asnjëherë të provojë interesin juridik për të iniciuar një procedurë pranë Gjykatës Kushtetuese në bazë të nenit 113 paragrafët 2 & 3 të Kushtetutës).

Kjo qasje si më sipër ekziston edhe në vendet tjera dhe është në harmoni me standardet më të larta të pavarësisë së gjyqësisë kushtetuese, duke u siguruar që edhe në dukje të ndodhë një demonstrim i pavarësisë objektive të Gjykatës Kushtetuese kundrejt çdo institucioni tjetër shtetëror.

Të gjithë gjyqtarët kushtetues, si dhe Kryetari e Zëvendëskryetari i Gjykatës Kushtetuese gjatë mandatit të tyre kanë në posedim nga një makinë, të cilën e drejtojnë vetë (përveç Kryetarit), por mund të ndihmohen edhe nga vozitësit e Gjykatës. Krahas këtij privilegji, gjyqtarët, Kryetari e Zëvendëskryetari kanë të drejtën e mbushjeve të caktuara të telefonave të tyre zyrtarë. Mëditjet për udhëtime jashtë vendin, si dhe kompensimet tjera rregullohen me të njëjtin ligj që vlen për krejt zyrtarët e lartë të **Republikës së Kosovës**, me përjashtim të kompensimeve që bëhen për punë shtesë brenda Gjykatës (jashtë punës juridiksionale si gjyqtarë kushtetues). Përveç këtyre, gjyqtarët që kanë vendbanimin jashtë selisë së Gjykatës, marrin një kompensim nga 300 (treqind) euro në muaj për qiranë e banesës së tyre në territorin e Prishtinës. Këto tarifa të qirasë përcaktohen në mënyrë autonome nga vetë Gjykata me vendim të veçantë administrativ.

Pas mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues, gjyqtarët dhe ish-Zëvendëskryetari nuk i ruajnë këto privilegje: sipas ligjit, privilegjet i gëzon vetëm ish-**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**. Në fakt, më këtu nuk flitet për privilegje, por për përfitime për punën e kryer në të kaluarën si **Kryetar i Gjykatës Kushtetuese**. Kjo përcaktohet me **Ligjin Nr. 03/L-001 për Përfitimin e ish-Zyrtarëve të Lartë** të datës 19 qershor 2008,[161] me ndryshimet e plotësimet e mëvonshme të tij.[162] Sipas këtij ligji, ish-Kryetarit të Gjykatës i takojnë përfitimet me kusht që ka ushtruar funksionin e kryetarit së pakut gjashtë muaj. Nuk e merr një përfitim të tillë nëse ajo/ai ushtron ndonjë funksion për të cilin paguhet nga **Buxheti Konsoliduar i Kosovës** dhe për të cilin është përcaktuar një pagë e barabartë ose më e lartë se paga që ka marrë gjatë ushtrimit të funksionit në krye të Gjykatës Kushtetues. Përveç këtyre dy kushteve, ekziston edhe një kusht tjetër thelbësor ligjor: ish-funksionarit të lartë nuk i takon përfitimi i përcaktuar me këtë ligj nëse gjatë ushtrimit të funksionit është shpallur fajtor me vendimin e formës së prerë të gjykatës për vepër penale të dënueshme me burgim mbi

[158] Cf. Neni 42. 4 ["Përparësia në Republikën e Kosovës"] i Ligjit Nr. 03/L-132:
"[…] 4. Personat "ish" dhe të dalë në pension radhiten më poshtë se ata që kanë zënë vendet e tyre në detyrë […]".

[159] Qeveria e Kosovës/Ministria e Shërbimeve Publike: **Udhëzim Administrativ Nr. MSHP 2004/07 për Udhëtimet Zyrtare** i datës 20.10.2004. Arkivi i MSHP. Qeveria e Republikës së Kosovës. Prishtinë.

[160] Neni 20 ["Presidenti/ja i/e Republikës""] i **Ligjit Nr. 03/L-132**: "[…] 3. Obligohen të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës që në mjediset e tyre ta vendosin fotografinë e Presidentit. Përmasat minimale duhet të jenë 40 – 60 cm."

[161] *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*. Prishtinë: Viti III/ Nr. 33/ 15 korrik 2008.

[162] *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*. Prishtinë: Nr. 25/ 14 nëntor 2011.

gjashtë muaj. Me plotësimin e këtyre kushteve, ish-Kryetari i Gjykatës realizon një të ardhur mujore në lartësi prej 70% të pagës aktuale të funksionit përkatës, si përfitim për punën e kryer në të kaluarën. Krahas këtij përfitimi, asaj/atij i takon, pavarësisht nga ligjet e shërbimit civil, një asistent i lartë, një vozitës dhe një truprojë.[163] Këto përfitime përbëjnë një të drejtë të fituar, e cila mbrohet me standardet e **GJEDNJ**.

12.3.3. Imunitetet dhe shkarkimi

Ka shtete që nuk parashohin (ofrojnë) imunitet penal për gjyqtarët kushtetues, përkatësisht fare nuk kanë dispozita kushtetuese apo ligjore që rregullojnë imunitetet e gjyqtarëve kushtetues (apo gjyqtarëve të gjykatave të larta që kryejnë funksione kushtetuese).[164] Në **Kosovë** ky nuk është rasti: si në shumicën e vendeve të demokracive kushtetuese të proveniencës liberale perëndimore, Kushtetuta në nenin e saj 117 flet për imunitetin, në një paragraf të vetëm. Aty thuhet si vijon:

"Neni 117 ["Imuniteti"] i Kushtetutës: "Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga detyra për vendimet e marra, mendimet e shprehura dhe veprimet e marra brenda fushës së përgjegjësive si gjykatës të Gjykatës Kushtetuese".

Nga redaktimi i këtij neni del qartë se gjyqtarët kushtetues janë të veshur me imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga detyra për sa i përket kryerjes së funksionit të tyre, mendimeve të shprehura, dhe në tërësi veprimeve të ndërmarra në kapacitetin e tyre si gjyqtarë kushtetues. Këtu bëhet fjalë për **imunitet funksional** të gjyqtarëve kushtetues, i emërtuar nganjëherë edhe si **imunitet nga përgjegjësia** (**non-liablity**). Me këtë nënkuptohet se gjyqtarët kushtetues nuk janë të imunizuar nga veprimet e ndërmarra jashtë funksionit të tyre si gjyqtarë kushtetues.

Gjykata Kushtetuese në rastin **KO 98/11**[165] ka pasur rast që të interpretojë këtë dispozitë kushtetuese duke saktësuar natyrën juridiko-kushtetuese dhe parametrat vlerësues të imunitetit funksional të funksionarëve të lartë shtetëror në **Kosovë**. Pavarësisht kësaj, nuk janë të pakta shtetet që u njohin gjyqtarëve kushtetues kategorinë e **imunitetit të përgjithshëm/ absolut (non-violability)**.[166] Në këto shtete, një gjyqtar kushtetues konsiderohet penalisht përgjegjës: gjatë ushtrimit të mandatit, megjithatë, ajo/ai nuk mund të arrestohet, ndiqet penalisht apo të dërgohet nëpër procedura gjyqësore penale, civile apo administrative. Nuk ka rëndësi nëse vepra është kryer gjatë apo para fillimit të mandatit si gjyqtar kushtetues. Këtu, me një fjalë, nuk ka rëndësi natyra e veprës, përfshirë këtu veprat që fare nuk kanë të bëjnë me ushtrimin e funksionit gjyqësor. Çdo gjë pezullohet. Asgjë nuk mund të lëvizë përpara gjatë tërë kësaj kohe sa zgjat mandati.[167]

Dy kategoritë e mësipërme të imunitetit zakonisht përcaktohen me kushtetutë nacionale. Të rralla janë rastet kur imuniteti caktohet me ligj të zakonshëm. Ky standard preferohet më shumë nga shkaku se ligjvënësit jo rrallë kanë pririe për të zgjeruar rrethin e personave me imunitet, në veçanti të atyre me **imunitet të përgjithshëm/absolut**, gjë që përbën një pengesë serioze për luftimin e korrupsionit.[168] U mor vesh, jo rrallë,

---

163 Cf. Neni 3 pikat 1 deri 4 ["Përfitimi Monetar, Personeli mbështetës, dhe Hapësirë Zyre"] i **Ligjit Nr. 03/L-001.**

164 Në këtë grup të shteteve hyjnë, ta zëmë, vendet si Austria, Belgjika, Gjermania, Finlanda, Franca, Irlanda, Japonia, Lihtenshtajni, Kanada, Malta, Norvegjia, Suedia dhe Zvicra. Cf. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *The Composition of Constitutional Courts,* fq. 18.

165 *Rasti KO 98/11. Aktgjykim. Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Nr. ref.: AGJ138/11). Prishtinë: datë: 20 shtator 2011.

166 Në literaturë është vërejtur se në Evropë nga 47 vendet anëtare të KE në vitin 2011, 20 syresh e njohin këtë lloj të imunitetit për gjyqtarët e gjykatave të larta, përfshirë gjyqtarët kushtetues. Cf. Tilman Hoppe, "Public Corruption: Limiting Criminal Immunity of Legislative, Executive and Judicial Officials in Europe" *Vienna Journal of International Constitutional Law* Vol. 5 No. 4 (2001) fq. 538-549, në fq. 539-540.

167 Ky lloj imuniteti njihet si **imuniteti i paprekshmërisë** (**inviolability**) dhe është më i vjetri dhe më i përhapuri në **Evropë**: në shumicën e shteteve evropiane ky lloj imuniteti njihet për parlamentarët, kurse më pak për gjyqtarët dhe oficerët e larët të ekzekutivit të vendit. Kjo vlen për vendet e demokracive tradicionale evropiane, me përjashtim të **Italisë**. Në disa vende ish-komuniste të **Evropë,** ky imunitet shtrihet edhe ndaj gjyqësorit, përfshirë gjykatat kushtetuese. Ibid. fq. 539-540.

168 Ibid. fq. 545.

kushtetutat (dhe ligjet) sanksionojnë dy llojet e imunitetit, duke e specifikuar procedurën dhe mekanizmin e heqjes vetëm sa i përket kategorisë së **imunitetit të përgjithshëm/absolut.**

Kategoria e **imunitetit funksional** të gjyqtarëve në përgjithësi, përfshirë edhe gjyqtarët kushtetues, siç do të përshkruhet në vijim, përbën një standard të përkrahur fuqishëm nga **Komisioni i Venecias.**[169] Si i tillë, ai është sanksionuar me një marrëveshje shumëpalëshe ndërkombëtare të **Këshillit të Evropës** qysh në vitet e para formative të **GJEDNJ**. Kjo marrëveshje e bën të qartë se imuniteti nuk është dhe nuk guxon të jetë qëllim në vete: ai i shërben pavarësisë së gjyqtarit në mënyrë që ajo/ai mos të ketë frikë se do të përndiqet nëpër procedura gjyqësore për detyrat që i ka ushtruar me mirëbesim dhe ndershmërisht në kohën sa ka qenë gjyqtar.[170] Këtë orientim e ka përqafuar në mënyrë të qartë dhe shprehimore Kushtetuta në nenin e sipërcituar 117: pjesa e fundit e fjalisë e identifikon në mënyrë të qartë kategorinë e **imunitetit funksional** kur saktëson se me imunitet mbulohen vetëm vendimet, mendimet dhe veprimet e ndërmarra brenda fushës së përgjegjësive si gjykatës i Gjykatës Kushtetuese. Kjo është arsyeja pse as Kushtetuta e as ***Ligji*** **Nr. 03/L-121** nuk përcaktojnë mekanizmin për heqjen e tij.

---

169 "[…] 19. Si përfundim, gjyqtarët duhet të gëzojnë vetëm imunitet funksional, përkatësisht imunitet nga ndjekja penale vetëm për aktet e ligjshme të ndërmarra gjatë kryerjes së funksioneve të tyre. Në këtë kuptim, duhet qartë që korrupsioni pasiv, ushtrimi i ndikimit, mitmarrja dhe veprat e ngjashme nuk mund të konsiderohen akte të kryera gjatë ushtrimit të ligjshëm të funksioneve gjyqësore […]". European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), ***Amicus Curiae Brief*** *on the Immunity of Judges for the Constitutional Court of Moldova*. Adopted by the Venice Commission at Its 94th Plenary Session (Venice, 8-9 March 2013). **689/2012. CDL – AD (2013) 008.** Original: English. Opinion Strasbourg, 11 March 2013. Në internet: https://www.venice.coe.int/ webforms/ documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2013)008-e (shikuar në prill 2018).
Pikëpamje të ngjashme, **Komisioni Venecias** ka shprehur edhe në rastet tjera të ngjashme: European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Memorandum Reform of the Judicial System in Bulgaria. Conclusions* adopted by the Venice Commission at its 55th plenary session (Venice, 13-14 June 2003). **Opinion N° 246/2003**. **Strasbourg**, 20 June 2003. CDL-AD (2003)12 Or. Engl. Në internet: http://www.venice coe. int/webforms/documents/default. aspx?pdffile=CDL-AD(2003)012-e (shikuar në prill 2018). (në paragrafin nr. 15 nën "a", Memorandumi konstaton se gjyqtarët, përfshirë gjyqtarët kushtetues nuk duhet të gëzojnë imunitet të përgjithshëm/absolut por vetëm funksional dhe duhet të jenë përgjegjës për veprat e kryera penale si çdo qytetar tjetër, kurse nuk duhet të jenë përgjegjës civil për dëmet e shkaktuara gjatë ushtrimit të funksionit të tyre me mirëbesim dhe ndershmëri; memorandumi po ashtu konstaton se nuk mund të bëhet dallim në mes të imunitetit të parlamentarëve dhe gjyqtarëve, përfshirë gjyqtarët kushtetues kurse për heqjen e imunitetit konstaton se kërkesa për këtë nuk duhet të vij vetëm nga prokurori i përgjithshëm); European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Report on the Independence of the Judicial System. Part I: The Independence of Judges,* (në paragrafin nr. 61 të këtij studimi theksohet pakontestueshmëria e imunitetit funksional të cilin duhet ta gëzojnë gjyqtarët, përkatësisht imunitetin për aktivitet e ushtruara gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare; përjashtim nga imuniteti në këtë paragraf, në mënyrë shprehimore, përbëjnë veprat penale të korrupsionit dhe krimit tjetër të kryer me qëllim); European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Opinion on the Draft Law on Judges and Prosecutor of Turkey*. Adopted by the Venice Commission at its 86th Plenary Session (Venice, 25-26 March 2011). **Opinion No. 610 / 2011**. **Strasbourg**, 29 March 2011. CDL-AD(2011)004 Or. Engl. Në internet: http://www. europarl.europa.eu/meetdocs/2009 _2014/ documents/d-tr/ dv/ 112817/ 112817 en.pdf (shikuar në prill 2018) (ky mendim në paragrafin nr. 88 përsërit qëndrimin e mëhershëm të Komisionit për imunitet funksional); European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Opinion on Act CLI of 2011 on the Constitutional Court of Hungary.* Adopted by the Venice Commission at its 91st Plenary Session (Venice, 15-16 June 2012). **Opinion no. 665 / 2012. Strasbourg**, 19 June 2012. CDL-AD(2012)009 Or. Engl. Në internet: http:// www.venice. coe.int/webforms/ documents/default.aspx? pdffile=CDL-AD(2012)009-e (shikuar në prill 2018) (në paragrafin nr. 14 të Mendimit thuhet se imuniteti funksional ngelet prioritet i Komisionit dhe përbën një standard evropian; sa i përket përgjegjësisë civile, Komisioni i rekomandon **Hungarisë** standard evropian: që të mbajë përgjegjës gjyqtarët vetëm në ato raste kur dëmi është shkaktuar me qëllim të keq dhe si pasojë e ushtrimit të pandërgjegjshëm të detyrës); European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Opinion on Proposals Amending the Drfat Law on the Amendments to the Constitution to Strengthen the Independence of Judges of Ukraine.* Adopted by the Venice Commission at its 97th Plenary Session (Venice, 6-7 December 2013). **Opinion no. 747 / 2013**. **Strasbourg,** 10 December 2013. CDL-AD(2013)034 Or.Engl. Në internet: http:// www.venice.coe.int/ webforms /documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2013)034-e (shikuar në prill 2018) (mendimi kritikon imunitetin e fuqishëm që u njihet gjyqtarëve dhe propozon ndryshimin e kushtetutës meqë këto imunitetet të përgjithshme/absolute garantohen me kushtetutë e jo me ligjin që ka qenë objekt i këtij mendimi).

170 Neni 6 i **Protokollit të Katërt të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Këshillit të Evropës** e vitit 1961 përcakton si vijon:
"Privilegjet dhe imunitetet e dhëna gjyqtarëve nuk janë për përfitim të tyre personal por me qëllim që të sigurohet ushtrimi i pavarur i funksioneve të tyre. Askush nuk është kompetent përveç Gjykatës, në një mbledhje plenare, për të vendosur për të hequr imunitetin e gjyqtarëve; ajo jo vetëm që ka të drejtë, por edhe detyrë për të hequr imunitetin e një gjyqtari në rastet kur, sipas mendimit të saj, imuniteti mund të pengoj kursin e drejtësisë me kusht që kjo heqje mund të bëhet pa paragjykuar qëllimin për të cilin imuniteti është dhënë" **Fourth Protocol to the General Agreement on Privileges and Immunities of the Council of Europe**. Paris, 16. XII. 1961. European Treaty Series - No. 36. Në internet: https://rm.coe.int/CoERMPublic Common SearchServices/ DisplayDCTMContent? documentId =090000 168006b643 (shikuar në mars 2018).

Kjo është kështu edhe në vendet tjera sepse supozohet që tekstet kushtetuese përmbajnë dispozita të qarta kur njohin (ofrojnë) kategorinë e imunitetit funksional. Thënë me fjalë të tjera, në vendet ku njihet (ofrohet) ky lloj imuniteti bëhet fjalë për përshkrim të punëve dhe detyrave të punës së një gjyqtari kushtetues ashtu që, pa ndonjë vështirësi, mund të identifikohet kategoria e imunitetit funksional që konsiston në imunizimin e funksionit të vendimmarrjes së gjyqtarit kushtetues me qëllim të sigurimit të pavarësisë së saj/tij nga ndikimi dhe presioni i jashtëm. Pikërisht kjo është arsyeja përse vendet që përqafojnë **imunitetin funksional** zakonisht nuk parashikojnë veprën penale të shpërdorimit të detyrës zyrtare për gjyqtarët kushtetues, duke rezervuar këtë lloj të veprës penale vetëm për kategorinë e shërbyesve civil.[171]

Sa i përket imunitetit nga procedurat civile dhe administrative, vlen të theksohet se këtu nuk ka ndonjë standard shprehimor. Mund të thuhet se, megjithatë, në rastet e dëmit civil apo lëshimeve administrative, gjyqtari kushtetues nuk duhet të ketë asnjë përgjegjësi nëse bëhet fjalë për aktivitetin e ndërmarrë (vendimet, mendimet dhe veprimet) në kuadër të ushtrimit të përgjegjësive si gjyqtarë kushtetues. Në disa vende, si në **SHBA**, sikundër do të shihet në vijim, përgjegjësia civile në tërësi përjashtohet, përfshirë këtu rastet kur dëmi ka rezultuar nga një vepër e pastër penale, siç është rasti me veprën penale të korrupsionit.

Kosova nuk u njeh gjyqtarëve kategorinë e **imunitetit të përgjithshëm/absolut**, siç u pa nga redaktimi i nenit 117 të Kushtetutës së vitit 2008. Vetëm me **imunitet funksional** janë të veshur gjyqtarët kushtetues kosovarë. Ky imunitet është relativ për faktin se vlen dhe mbulon ekskluzivisht vetëm sferën që ka të bëjë me procesin e vendimmarrjes së gjyqtarit kushtetues. Kjo nënkupton se për çështjet tjera, ajo/ai në tërësi i nënshtrohet legjislacionit penal, civil dhe administrativ si çdo qytetar tjetër i **Kosovës**. Kjo përbën, në fakt, vetë thelbin e qëllimit të cilit i shërben **imuniteti funksional**: ai qëllim ka të bëjë pikërisht me garantimin e barazisë para ligjit për të gjithë.

Këtë kategori të imunitetit e ka mbrojtur fuqishëm **Gjykata Kushtetuese** në një interpretim të cilin e ka marrë lidhur me caqet dhe llojin e imuniteteve të funksionarëve shtetëror në **Kosovë**. Fjalën e kemi për interpretimin e dhënë në rastin e sipërpërmendur **KO 98/11**, ani që nuk ka pasur të bëjë në mënyrë shprehimore me gjyqtarët kushtetues. Ai rast ka pasur të bëjë në mënyrë shprehimore me Presidentin, Kryeministrin dhe anëtarët e Qeverisë dhe me deputetët e Kuvendit të Kosovës. Kjo fare nuk ka rëndësi sepse, interpretimi në fjalë, **mutatis mutandis**, vlen në tërësi edhe për vetë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese. Kjo është kështu për dy arsye: *e para*, sepse dispozitat kushtetuese lidhur me imunitetin e funksionarëve të lartë shtetëror të **Kosovës** dhe deputetëve të Kuvendit janë në tërësi të njëjta, përfshirë këtu dispozitat për imunitetin e gjyqtarëve të gjyqësorit të rregullt dhe **Avokatit të Popullit;**[172] *e dyta*, sepse gjyqtarët kushtetues gëzojnë

---

171 Tilman Hoppe, "Public Corruption: Limiting Criminal Immunity of Legislative, Executive and Judicial Officials in Europe", fq. 547-548.

172 E kemi fjalën për dispozitat e Kushtetutës që kanë të bëjnë me deputetët e Kuvendit (neni 75.1), Presidentin e Kosovës (89), Kryeministrin dhe anëtarët e Qeverisë (neni 98), gjyqtarët e gjyqësorit të rregullt (neni 107.1) dhe Avokatin e Popullit (134.4). Pikërisht për këtë arsye janë tërësisht të paqëlluara dhe joprofesionale konstatimet që thonë se **Gjykata Kushtetuese** me vendimin e vet në rastin **KO 98/11** ka rishkruar normat kushtetuese mbi imunitetin e funksionarëve të larët shtetëror të Kosovës. Cf. Dren Doli, Fisnik Korenica and Albana Rexha, *Promising Early Years: The Transformative Role of the Constitutional Court of Kosovo* (Analitika: Center for Social Research, Sarajevo, 2015) fq.62-64 (autorët, përveç kësaj, gabimisht mendojnë se rastin e ka ngritur **Kryeministri i Kosovës**, gjë që nuk është fare e vërtetë sepse Kryeministri nuk ka të drejtë të ngris çështje kushtetuese); Cf. ngjashëm edhe te Andrea Lorenzo Capussela, "A Critique of Kosovo's Internationalized Constitutional Court", fq 27-29.
Si në **Kosovë**, ashtu dhe gjetiu, gjykatat kushtetuese nuk bëjnë asgjë pos interpretojnë normat juridike duke shikuar nëse ato janë në harmoni me kushtetutën. Që nga **Hans Kelsen** e deri më sot kjo ka qenë cilësia themelore që ka dalluar gjyqësinë kushtetuese nga gjyqësia e rregullt. Si produkt i pashmangshëm i kësaj cilësie ka qenë tjetra cilësi, e njohur si **prezumimi i kushtetutshmërisë së normave juridike** që janë në fuqi. I parë në këtë kontekst, në rastin **KO 98/11 Gjykata Kushtetuese** vetëm ka konfirmuar, përmes riinterpretimit, se në **Kosovë** ekziston vetëm një lloj imuniteti, **imuniteti funksional** apo **imuniteti nga përgjegjësia** (**non-liability**), duke sqaruar dy gjëra: e para, se në Kosovë ka vetëm një lloj imuniteti, diçka që ende nuk është e qartë në Kosovë; dhe, dy, se arrestimet e funksionarëve të lartë shtetëror mund të ndodhin, njëjtë si në shumicën dërrmuese të vendeve të demokracive kushtetuese, për aktet dhe veprimet që nuk kanë të bëjnë me fushën e përgjegjësisë së tyre si deputet, anëtar i qeverisë dhe kryeministër dhe Avokat i Popullit.
I vetmi përjashtim në këtë drejtim, sipas sqarimit të **Gjykatës Kushtetuese** në rastin **KO 98/11**, ka të bëjë me Presidentin: ajo/ai nuk mund të arrestohet në asnjë rrethanë gjatë kohë sa mban postin e shefit të shtetit. Këto standard, siç do të shihet në vijim, janë të ngulitura thellë në punën dhe mendimet e **Komisionit të Venecias** dhe në vendet që përqafojnë demokracinë kushtetuese liberale. Thënë me fjalë tjera, në vijim do të shihet se **imuniteti funksional** dominon në pjesën dërrmuese të kushtetutave të vendeve të **Evropës** dhe përtej saj.

statusin protokollar të ministrave të qeverisë dhe barazohen me **Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës**, kurse vetë **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese** gëzon rangun ceremonial dhe protokollar të Kryeministrit dhe Kryetarit të Kuvendit. Ky status i gjyqtarëve kushtetues është afërsisht kësisoj edhe në vendet tjera të modelit **evropian/kelsenian** të gjyqësisë kushtetuese.

Të shkëputemi për një moment nga çështja e imunitetit të gjyqtarëve kushtetues dhe të themi diçka që lidhet më ketë seksion në kuptimin më të gjerë të fjalës. Në lidhje me këtë, vlen të thuhen disa fjalë edhe për pozitën dhe rolin e kryetarit të gjykatës kushtetuese, bazuar në hulumtimet empirike të kryera së fundi. Sikundër dihet, në **modelin kelsenian/evropian**, gjykatat kushtetuese nuk kanë hierarki vertikale lëndore, administrative apo institucionale me sistemin gjyqësor nacional. Duke pasur juridiksion të ndarë, kryesisht i lindur në vijim të gjetjes së mekanizmave për kontroll juridik të pushtetit shtetëror dhe juridifikim të proceseve politike, gjyqtarët e këtyre gjykatave janë parë me shqetësim nga politika: në literaturë është vërejtur se ky shqetësim më së shumti është asociuar me rolin dhe pozitën, në thelb krejt administrativ dhe për qëllime të ceremoniale dhe protokollare, të kryetarëve të gjykatave kushtetuese.[173] Në veçanti, ky ka qenë rasti kur bëhet fjalë për ish vendet komuniste. **Kosova,** në këtë drejtim, nuk bën përjashtim: siç e kemi sqaruar më sipër në këtë kapitull dhe siç do të sqarohet tutje në vijim, në mandatin e kryetarit të parë të Gjykatës, autorë i parë i këtij libri, sulmi që ka ardhur në adresë të Gjykatës ka qenë i paparë dhe provon konstatimet shkencore të dhëna këtu, të cilat janë nxjerrë lidhur me gjykatat kushtetuese evropiane që u themeluan pas rrënimit të komunizmit në fund të viteve '80 të shekullit të kaluar.

Tani i kthehemi sërish temës bosht të këtij seksioni, imunitetit të gjyqtarëve.

Në vijim do ta shohim se cila ka qenë, sipas interpretimit të Gjykatës, natyra juridiko-kushtetuese e **imunitetit funksional,** si dhe parametrat që kanë shërbejnë si matës gjatë vendosjes lidhur me caqet e këtij imuniteti në rastin e sipërcekur **KO 98/11.**[174] Rasti ka pasur të bëjë me përgjigjen e Gjykatës ndaj pyetjes së Qeverisë lidhur me imunitetin e të gjithë funksionarëve qendror të Kosovës: Presidentit, Qeverisë, si dhe Kryetarit e deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Për shkak të rëndësisë së tij të madhe, vendimi ka shtjelluar në mënyrë ekstensive të gjitha format dhe caqet e imunitetit të funksionarëve të lartë të **Republikës së Kosovës.**[175]

Në pikën II të Aktgjykimit në rastin **KO 98/11**, Gjykata ka theksuar qartë se, në përputhje me nenin 75. 1, nenin 89 dhe nenin 98 të Kushtetutës, deputetet e Kuvendit te Kosovës, Presidenti i Republikës dhe anëtarët e Qeverise gëzojnë **imunitet funksional** për veprimet dhe

---

173 "Presidentët e gjykatave kushtetuese do të jenë çdoherë dhe gjatë tërë kohës në mes të betejave politike, nisur nga fakti se gjykatat në fjalë nuk mund të jenë apolitike për shkak të mandatit të tyre kushtetues që kanë." Kim Lane Scheppele, "A Comparative View of the Chief Justice's Role. Guardians of the Constitution: Constitutional Court Presidents and the Struggle for the Rule of Law in Post-Soviet Europe". *The University of Pennsylvania Law Review* Vol. 154 Issue 6 (2006) fq. 1757-1851 në fq. 1764 (ky shkrim është një studim i rolit dhe pozitës së presidentëve të gjykatave kushtetuese evropiane dhe më gjerë, krahasuar me rolin dhe pozitën e presidentëve të gjykatave më të larta në nivel nacional që modelohen sipas sistemit amerikan dhe që janë pjesë përbërëse e sistemit gjyqësor; shkrimi është pjesë e trajtimeve tjera të thella të prezantuara në simpoziumin me titull "kryegjyqtari dhe gjyqësia institucionale", që flet për rolin dhe pozitën kushtetues të kryetarëve të gjykatave kushtetuese apo gjykatave të tjera të barasvlefshme me to; ky numër i revistës së Universitetit të Pensilvanisë si më sipër i kushtohet në tërësi këtij simpoziumi; aty gjenden kumtesat dhe hulumtimet e të gjithë emrave më eminent të së drejtës kushtetuese në dy anët e Atlantikut).

174 *Rasti 98/11. Aktgjykim. Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Nr. ref.: AGJ138/11). Prishtinë: datë: 20 shtator 2011.

175 Paragrafi 2 i Aktgjykimit në rastin KO 98/11:
"[...] 2. Me 20 korrik 2011, Gjykata Kushtetuese e Republikës se Kosovës (ne tekstin e mëtejme: Gjykata Kushtetuese) pranoi kërkesën nga Qeveria, e cila përmbante tri çështje të veçanta. Pyetjet që iu parashtruan Gjykatës kishin të bënin me imunitetin e organeve të ndryshme shtetërore të Kosovës, kryesisht të deputetëve të Kuvendit, Presidentit dhe anëtarëve të Qeverisë [...]". Cf. po ashtu edhe paragrafin 39, pikat A, B & C të të njëjtit aktgjykim, të cilat flasin për objektin dhe çështjen e që kanë pasur të bëjnë me imunitetin e deputetëve të Kuvendit, Presidentit të Republikës dhe anëtarëve të Qeverisë.

vendimet e ndërmarra brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre përkatëse.[176] Kjo nënkupton se, **per definitionem**, deputetet e Kuvendit, Presidenti i Republikës dhe anëtarët e Qeverisë lirohen nga përgjegjësia dhe procedurat ligjore të ***çfarëdo*** natyre lidhur pikëpamjet e shprehura, mënyrën e votimit apo vendimet e ndërmarra brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre. **Ky lloj i imunitetit ka kohëzgjatje të pakufizuar**. Në këtë drejtim, pra në drejtim të **imunitetit funksional**, të gjithë janë të barabartë dhe gëzojnë imunitet të njëjtë për veprim apo vendim të marrë brenda përgjegjësive të tyre. Fjalia ***çelës*** që ka përdorur Gjykata në rastin **KO 98/11** është fjalia **jashtë përgjegjësive të tyre**, pra çdoherë kur funksionarët publikë veprojnë apo vendosin jashtë përgjegjësive të tyre, ata nuk gëzojnë imunitet dhe mbrojtje të tipit të **imuniteti funksional**. Përjashtimi vlen vetëm për **Shefin e Shtetit** dhe atë vetëm sa i përket arrestimit të saj/tij, pra jo edhe sa i përket llojeve tjera të imunitetit: **Presidenti i Republikës**, për dallim nga funksionarët tjerë të lartë shtetërorë, gëzon imunitet nga arrestimi për shkak të natyrës së funksionit, i cili kërkon që ajo/ai të jetë përherë në dispozicion për t'i kryer detyrat.[177] Në lidhje me veprimet dhe vendimet tjera të Presidentit të Republikës që janë kryer apo ndërmarrë jashtë përgjegjësive të tij kushtetuese vlejnë rregullat e njëjta si për çdo qytetar të Republikës së Kosovës: kjo do të thotë se ajo/ai nuk mund të arrestohet, por mund të hetohet, akuzohet dhe të gjykohet për veprat dhe vendimet që janë ndërmarrë apo kryer jashtë përgjegjësive të saj/tij shtetërore.

Si veprime dhe vendime të kryera apo ndërmarra brenda përgjegjësive konsiderohen të gjitha ato që figurojnë në përshkrimin e punëve dhe detyrave të punës të përcaktuara me kushtetutë, ligje organike dhe akte të tjera të brendshme që normojnë organizimin, jetën dhe punën e institucionit përkatës shtetëror. Kjo nënkupton se deputetët, ministrat, Qeveria, Presidenti i Kosovës, gjyqtarët kushtetues dhe **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese,**[178] gjyqtarët e rregullt, eprorët e gjyqësorit të rregullt dhe kështu me radhë duhet në tërësi të zbatojnë dispozitat kushtetuese, ligjore dhe dispozitat e akteve tjera të brendshme që kanë të bëjnë me përshkrimin e saktë të detyrave dhe punëve që duhet t'i kryejnë. **Për gjyqtarët kushtetues, si dhe për gjyqtarët tjerë, gjëja më themelore është gjykimi dhe votimi në mënyrë të ndershme dhe sipas rregullave të profesionit i të gjitha rasteve të vëna para tyre për shqyrtim dhe vendosje.** Kjo do të thotë se gjyqtarët kushtetues, sikundër edhe gjyqtarët tjerë, nuk guxojnë dhe nuk mund të **abstenojnë** nga gjykimi dhe votimi asnjëherë, përveç rasteve të përcaktuara me ligj.[179] Në asnjë

---

176 Aktgjykimi në rastin **KO 98/11**:
"[...] II. Në përputhje me nenin 75 (1), nenin 89 dhe nenin 98 të Kushtetutës, deputetët e Kuvendit të Kosovës, Presidenti i Republikës dhe anëtarët e Qeverisë gëzojnë imunitet funksional për veprimet dhe vendimet e ndërmarra brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre përkatëse. Prandaj, deputetët e Kuvendit, Presidenti i Republikës dhe anëtarët e Qeverisë lirohen nga përgjegjësia në procedura gjyqësore të çfarëdo natyre mbi pikëpamjet e shprehura, mënyrën e votimit apo vendimet e ndërmarra brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre. Ky lloj i imunitetit ka kohëzgjatje të pakufizuar."

177 Aktgjykimi në rastin **KO 98/11**:
"[...] VII. 4. Presidenti nuk mund të arrestohet apo ndalohet gjatë mandatit te tij/saj për shkak te natyrës së funksionit të Presidentit, pasi ai/ajo kërkohet të jetë përherë në dispozicion për t'i kryer ato."

178 Cf. fusnotën nr. 182, infra, dhe komentet tona aty (ku tregohen dispozitat relevante që bëjnë dallim në mes të detyrave të gjyqtarit kushtetues që kanë natyrë juridiksionale dhe atyre që kanë karakter administrativ; këtu përfshihen edhe detyrat e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të Gjykatës).
Vlen të theksohet se në vendimet juridiksionale të Gjykatës Kushtetuese, që kanë formën ose të aktvendimit apo të aktgjykimit, çdoherë figurojnë të gjithë emrat e gjyqtarëve, pa marrë parasysh nëse është aktvendim apo aktgjykim, si dhe pa marrë parasysh nëse një gjyqtar ka vendosur pro ose kundër vendimit. I vetmi rast kur një emër i një gjyqtari nuk guxon të figurojë është kur gjyqtari ka qenë i **përjashtuar** me vendim të veçantë administrativ të Gjykatës Kushtetuese, për arsyet që i njeh **Ligjit Nr. 03/L-121** në nenin 18 ["Përjashtimi i gjyqtarit"]. Kjo më tutje nënkupton se asnjëherë nuk mund të hiqet emri i një gjyqtari nga vendimi nëse nuk ka një vendim tjetër të veçantë për përjashtim të saj/tij. I tillë ka qenë rasti me gjyqtarin **Kadri Kryeziu**, me vetë autorin e parë të këtij libri si dhe me disa gjyqtarë të tjerë që kanë qenë të përjashtuar nga disa gjykime konkrete për shkak të **konfliktit konkret të interesit** që kanë pasur. Zakonisht **vendimi për përjashtim** të një gjyqtari kushtetues i referohet rasteve të mëparshme të përjashtimeve. Si i tillë, ai përbën pjesë të aspektit procedural të vendimit lidhur me kërkesën e palës në një gjykim konkret. Kjo bëhet me qëllim të ruajtjes së kontinuitetit në praktikën gjyqësore të **Gjykatës Kushtetuese**, si një komponentë e rëndësishme e parimit kushtetues mbi sigurinë juridike. Në këtë kontekst, analizoni, ta zëmë, paragrafin 13 të vendimit të Gjykatës në rastin **KO 22/15**, i komentuar gjerësisht në fusnotat nr. 205, 246-255, **infra**, në këtë seksion, si dhe komentet tona aty. Rasti i fundit kur Gjykata Kushtetuese ka vendosur për përjashtimin e gjyqtarit, deri në momentin e shkrimit të këtyre rreshtave, ka qenka qenë kur ka vendosur lidhur me rastet e bashkuara **KI 48/14** dhe **KI 49/14.** Cf. fusnota nr. 92, **supra**, në këtë kapitull, si dhe komentet tona aty.

179 Neni 19 ["Marrja e vendimeve"] i **Ligjit Nr. 03/L-121**:
"1. Gjykata Kushtetuese vendos si trup gjykues i përbërë prej të gjithë gjyqtarëve të pranishëm të Gjykatës Kushtetuese.
2. Gjykata Kushtetuese ka kuorum nëse janë të pranishëm shtatë (7) gjyqtarë.
3. Gjykata Kushtetuese merr vendime me shumicën e votave të gjyqtarëve që janë të pranishëm dhe që votojnë.
4. Secili gjyqtar është i obliguar për të votuar për ose kundër vendimit."

vend nuk ekziston dhe nuk njihet **institucioni i abstenimit** të gjyqtarit nga votimi dhe vendimmarrja në gjykim: gjyqtarët nuk kanë të drejtë të abstenojnë nga votimi dhe pjesëmarrja në gjykimin e rastit apo të mosmarrëveshjes konkrete që gjendet pranë tyre. Përjashtimi i një gjyqtari nga ky proces votimi dhe vendimmarrjeje përcaktohet qartë me ligj dhe çdoherë duhet të vendoset për një gjë të tillë nga ana e trupës gjykuese apo eprori më i lartë, pra vetë gjyqtari asnjëherë nuk mund të vendos në mënyrë autonome për përjashtim nga rasti.[180] Përjashtimi duhet të jetë transparent dhe arsyet për një gjë të tillë duhet të bëhen publike për palët dhe trupën gjyqësore apo eprorin (në rastet kur ajo/ai vendos lidhur me përjashtimin sipas ligjit, siç është rasti me gjykatat e rregullta). Procedurat e vendimmarrjes për përjashtim dallojnë nga vendi në vend: e përbashkëta e të gjitha procedurave të përjashtimit është se organi vet vendos në mënyrë autonome sipas rregullave të paracaktuara ligjore dhe normave tjera të përgjithshme. Këto rregulla janë të përgjithshme dhe kanë të bëjnë me autonominë dhe detyrimin juridiksional të një gjyqtari, të cilit ajo/ai nuk mund t'i shmanget në mënyrë arbitrare dhe okulte. Kjo nuk vlen, megjithatë, kur bëhet fjalë për punë dhe detyra që nuk kanë natyrë juridiksionale, por natyrë **administrativo-teknike**: në këto raste, gjyqtarët kanë të drejtë të abstenojnë nga votimi dhe procesi i vendimmarrjes. Kjo përbën esencën e autonomisë personale të gjyqtarëve ashtu që shprehja e saj nuk mund të tërheqë me vete asnjë pasojë ligjore për ata që e shprehin.[181] Kjo nënkupton se gjykimi lidhur me këto veprime **administrativo-teknike** i nënshtrohet kritereve të njëjta që vlejnë për çdo qytetar të **Kosovës** ashtu që nuk ka asnjë nevojë për sqarim apo marrje të lejes për nisen

---

180 Përjashtimin e gjyqtarit kushtetuese e rregullon përveç nenit të sipërcekur 18 të **Ligjit Nr. 03/L-121** edhe **RP**. Kjo e dyta vetëm sa saktëson dhe operacionalizon më tutje dispozitat e ligjore, asgjë më shumë. Këtë gjë e bën në vetëm një rregull, në rregullën 7 ["Procedurat për përjashtim"], e cila thotë si vijon:
"(**1**) Sapo gjyqtari të mësojë ndonjë arsye për përjashtim të paraparë me nenin 18 të Ligjit për Gjykatën, ose nëse gjyqtari beson që ekzistojnë rrethana të tjera që ngrenë dyshim të arsyeshëm përkitazi me paanësinë e tij/saj, ai/ajo do të përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurë dhe do t'ia shpjegojë arsyen me shkrim Kryetarit të Gjykatës. Një kopje e atij shpjegimi do t'u dërgohet të gjithë gjyqtarëve.
(Ndryshuar më 4 dhjetor 2012; ndryshuar më 28 tetor 2014)
(**2**) Cilado palë në procedurë mund të paraqesë kërkesë për përjashtimin e një gjyqtari sapo t'i kuptojë arsyet për përjashtim dhe jo më vonë se një javë para fillimit të seancës dëgjimore, nëse ka, ose para se të merret vendimi nga Gjykata. (Ndryshuar më 4 dhjetor 2012).
(**3**) Në peticion, pala duhet t'i prezantojë faktet dhe rrethanat me të cilat e arsyeton përjashtimin e gjyqtarit. Arsyet e cekura në peticionin paraprak për përjashtimin që ishte refuzuar nuk mund të përfshihen në peticionin e ri për përjashtim. Kopje të atij peticioni do t'u dërgohen të gjithë gjyqtarëve. Gjyqtari përjashtimi i të cilit kërkohet mund të përgjigjet duke u përjashtuar nga procedura dhe duke njoftuar me shkrim Kryetarin e Gjykatës. Një kopje e përjashtimit me shkrim të gjyqtarit i dorëzohet të gjithë gjyqtarëve. (Ndryshuar më 4 dhjetor 2012; ndryshuar më 28 tetor 2014).
(**4**) Nëse gjyqtari, përjashtimi i të cilit kërkohet nga pala, nuk përjashtohet, Gjykata me shumicën e votave të gjyqtarëve vendos për peticionin për përjashtim. Para marrjes së vendimit për përjashtimin e kërkuar, merret një deklaratë nga gjyqtari, përjashtimi i të cilit kërkohet dhe, nëse është nevoja, do të sigurohen edhe sqarime të tjera. Gjyqtari, përjashtimi i të cilit kërkohet, nuk mund marrë pjesë në procedurën e marrjes së vendimit. Vendimi i Gjykatës u dorëzohet palëve në procedurë. (Ndryshuar më 4 dhjetor 2012; ndryshuar më 28 tetor 2014).
(**5**) Nëse ndonjë gjyqtar i Gjykatës mëson për ndonjë arsye për përjashtimin e ndonjë gjyqtari tjetër, siç parashihet me nenin 18 të Ligjit për Gjykata, ai/ose ajo njofton Kryetarin e Gjykatës, i cili kërkon përgjigje nga gjyqtari. Nëse arsyeja është e bazuar mirë dhe gjyqtari nuk vetë përjashtohet, Gjykata me shumicë votash të gjyqtarëve, vendos përkitazi me përjashtimin. (Ndryshuar më 4 dhjetor 2012; ndryshuar më 28 tetor 2014).
(**6**) Kur gjyqtari përjashtohet nga procedura, Gjykata shënon në çdo vendim me shkrim apo aktgjykim se gjyqtari i përjashtuar nuk kishte marrë pjesë në procedurë. (Ndryshuar më 4 dhjetor 2012)".

181 Rregulli 14 ["Seancat administrative"] i **RP** (Miratuar më 23 nëntor 2010):
"(**1**) Gjyqtarët takohen në seanca administrative për të diskutuar dhe për të vendosur për çështjet e politikave që kanë të bëjnë me administrimin e Gjykatës. Kur është e nevojshme, nën udhëheqjen e Kryetarit, Sekretariati harton propozimet e politikave për shqyrtim dhe për miratim nga Gjykata.
(**2**) Seancat administrative të Gjykatës thirren nga Kryetari, i cili kryeson takimet. Gjykata takohet në seanca administrative së paku dy herë në vit, ose në bazë të kërkesës me shkrim të bërë nga ndonjëri gjyqtar ose nga Sekretariati.
(**3**) Çështjet që kanë të bëjnë me administrimin e Gjykatës përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në:
(a) buxhetin e Gjykatës;
(b) personelin;
(c) shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e objektit;
(d) bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar;
(e) gjobat për shkeljet e bëra gjatë procedurës;
(f) organizimin e brendshëm dhe funksionimin e Gjykatës;
(g) statusin dhe çështjet kontraktuese që përfshijnë Sekretariatin dhe këshilltarët juridikë;
(h) kushtet e punësimit, orarin e punës, kompensimin dhe Kodin e etikës për stafin administrativ të Sekretariatit; dhe (Miratuar më 4 dhjetor 2010)
(i) miratimin e raportit vjetor.
(**4**) Në seanca administrative vendimet merren me shumicën e votave të gjyqtarëve të pranishëm dhe që votojnë, me kusht që të jenë të pranishëm të paktën pesë (5) gjyqtarë. (Miratuar më 17 qershor 2013)".

dhe vazhdimin e procedurave eventuale ligjore (administrative, penale, civile dhe kushtetuese). Kur veprojnë si gjyqtarë kushtetues, ata kanë detyra të qarta të përcaktuara me ligj në kuadër të funksionit të tyre si gjyqtarë kushtetues.[182] Ky nuk është rasti me Kryetarin dhe Zëvendës Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese, të cilëve ligji u jep disa detyra shtesë të natyrës administrative, krahas atyre juridiksionale që i kanë si gjyqtarë kushtetues.[183] Dallimi në mes të aspektit juridiksional të detyrave të gjyqtarëve kushtetuese, përfshirë këtu Kryetarin dhe Zëvendës Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese, dhe atij administrativo-teknik bën që kategoria e imunitetit funksional të rrjedhë natyrshëm si një imanencë e pavarësisë së gjyqtarit dhe të institucionit të gjykatës kushtetuese. Një gjë e tillë nënkupton që, për pasojë, **imuniteti funksional**, i përshkruar si më sipër gjatë analizës sonë të rastit **KO 98/11**, ka një natyrë tjetër: në parim, në këto raste nuk ka nevojë të kërkohet asnjë vlerësim nga organi kompetent me qëllim ndjekjes së procedurave përkatëse ligjore të natyrës penale, administrative dhe civile. Kjo sepse ky imunitet në tërësi mbulon procesin e vendimmarrjes së gjyqtarëve kushtetues dhe supozohet se çdokush duhet ta di një gjë të tillë. Kjo shpjegon faktin se përse në Kushtetutë nuk ka dispozita shprehimore që normojnë mekanizmin e heqjen apo sqarimin e këtij imuniteti.

Në vijim si më sipër, ekziston edhe një pyetje tjetër themelore që shtrohet lidhur me secilën kategori të imunitetit: kush duhet të vendos për caqet e **imunitetit funksional**, përkatësisht cili është organi që duhet të tregoj paraprakisht nëse mund të fillojnë procedurat ligjore ndaj një gjyqtari kushtetues, gjyqtari të rregullt apo ndaj një funksionari të lartë shtetëror. **Organi kushtetues dhe ligjor pranë të cilit duhet të fillojë procedura, qoftë ai organi i akuzës apo gjyqësori i një vendi, në asnjë vend asnjëherë nuk mund të vendos për një gjë të tillë.**[184] Ekzistojnë dy arsye pse qëndron ky konstatim i yni apodiktik. Arsyeja e parë konsiston në atë se një gjë e tillë do të binte ndesh me parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve.[185] Thënë ndryshe, sikur i njëjti organ që ka autorizimin ligjor për nisjen dhe vazhdimin e procedurave ligjore të vendoste në të njëjtën kohë edhe për caqet e **imunitetit** të palëve në procedurë, një gjë e tillë do të cenonte rëndë parimin themelor mbi ndarjen e pushteteve. Arsyeja e dytë pse kjo është kështu ka të bëjë me atë se **imuniteti** ka për funksion parësor pikërisht mbrojtjen funksionale të bartësve të tij ndaj ndërhyrjeve të organeve shtetërore që kanë autorizim për të nisur apo për të vazhduar me procedura ligjore (administrative, penale, civile dhe kushtetuese). Arsyeja e dytë është shumë univer-

---

182 Neni 10 ["Detyrat e gjyqtarëve"] i **Ligjit Nr. 03/L-121:**
"1. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese kanë për detyrë të ushtrojnë me ndërgjegje dhe në mënyrë të paanshme funksionin e gjyqtarit dhe të vendosin sipas bindjes së lirë në pajtim me Kushtetutën.
2. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese kanë për detyrë të ruajnë reputacionin dhe dinjitetin e Gjykatës Kushtetuese.
3. Secili gjyqtar ka për detyrë të marrë pjesë në punën dhe procesin e vendimmarrjes së Gjykatës, si dhe të kryej punët tjera të caktuara me ligj dhe me rregulloren e punës".

183 Vetëm Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Gjykatës Kushtetuese ka detyra të qarta administrative. Gjyqtarët kushtetues, sikundër shihet, nuk kanë individualisht autorizime administrative përveç në përbashkësi më tjerët në kuadër të vendimmarrjes për çështjet administrative. Kjo shpjegon pse në ligj ka dispozita për detyra administrative vetëm për Kryetarin dhe Zëvendës Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese. Këto dispozita gjenden në nenin 11 ["Kryetari dhe Zëvendës Kryetari"] të **Ligjit Nr. 03/L-121**, i cili përcakton si vijon:
"1. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese:
1.1. koordinon aktivitetet e Gjykatës Kushtetuese dhe punën e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese;
1.2. thërret dhe drejton seancat verbale të Gjykatës Kushtetuese;
1.3. përfaqëson Gjykatën Kushtetuese;
1.4. nënshkruan aktet e Gjykatës Kushtetuese;
1.5. kryen detyra të tjera të përcaktuara me këtë ligj ose me rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese.
2. Zëvendëskryetari i Gjykatës Kushtetuese ushtron detyrat e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese kur ky i fundit mungon ose për çfarëdo arsye tjetër nuk është në gjendje të ushtrojë detyrat e tij. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese mund t'ia delegojë Zëvendëskryetarit disa detyra të caktuara për të mbështetur Kryetarin në ushtrimin e detyrave të tij."

184 Cf. Tilman Hoppe, "Public Corruption: Limiting Criminal Immunity of Legislative, Executive and Judicial Officials in Europe", fq. 544-555.
Në shumicën e vendeve, heqjen e imunitetit e bëjnë vetëm gjykatat kushtetuese, pra ato vetë vendosin për heqjen e imunitetit të anëtarëve të vet, kurse shefi i shtetit vetëm formalisht miraton propozimin e gjykatave kushtetuese për përjashtim. Në rastet tjera, por shumë më rrallë, organi që vendos për përjashtim është autoritetit që i ka caktuar (parlamenti, shefi i shtetit apo gjyqësori i lartë). Ai organ nganjëherë mund të jetë këshillit gjyqësor. Cf. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *The Composition of Constitutional Courts,* fq. 17.

185 Tilman Hoppe, "Public Corruption: Limiting Criminal Immunity of Legislative, Executive and Judicial Officials in Europe", fq. 555.

sale dhe qëndron si e pandryshueshme në çdo kohë dhe hapësirë, pa marrë parasysh rregullimin shtetëror, në ndërkohë që kjo mund të mos jetë kështu kur bëhet fjalë për arsyen e parë: sikundër u pa, në disa vende ende dhomat e caktuara të parlamentit nacional vendosin për caqet e imunitetit të gjyqtarëve kushtetues. Në të kaluarën, në vendet ish-komuniste për imunitetin po ashtu kanë vendosur kuvendet si organe më të larta të pushtetit komunist: **raison d'etre** e ekzistimit të **imunitetit** të gjyqtarëve kushtetuese dhe gjyqtarëve të rregullt në vendet ish-komuniste ka qenë pjesë e botëkuptimit të tyre mbi kuvendin si organi më i lartë i pushtetit, ku pushteti ka qenë unik dhe i pandarë me partinë komuniste si avangardë të këtij pushteti.

Në vijim, si më sipër, si në rastin e arsyes së parë ashtu dhe të asaj të dytës, vlen të theksohet se, megjithatë, ekziston një pikë e përbashkët në mes tyre: organi që vendosë për caqet e **imunitetit** duhet ti ketë dy cilësi. Cilësia e parë konsiston në atë se ai organ qëndron jashtë sferës së pushtetit dhe autoritetit të organeve që vendosin lidhur me fillimin apo vazhdimin e procedurave ligjore (administrative, civile, penale apo kushtetuese). Cilësia e dytë ka të bëjë me faktin se organi i tillë vendimmarrës lidhur me caqet e imunitetit shumë shpesh është i njëjtë me organin që ka dhënë imunitetin. Thënë ndryshe, kjo do të thotë se organi vendimmarrës lidhur me caqet e imunitetit është po ai organ që i ka veshur me imunitet gjyqtarët, kushtetues apo të rregullt, si dhe funksionarët e tjerë të lartë shtetëror. Në ndërkohë që, sikundër u tha më sipër, organi që vendos për caqet e imunitetit mund të jetë i njëjtë me vetë organin që vlerëson këto caqe, **asnjëherë zhveshjen nga imuniteti dhe interpretimin e caqeve të tij nuk mund ta bëjë organi që ka kompetencën për fillimin apo vazhdimin e procedurave ligjore si më sipër.**

Kushtetuta e vitit 2008, është e heshtur lidhur me çështjen e procedurës për heqjen apo saktësimin e caqeve të imunitetit të gjyqtarëve kushtetues. Më një fjalë, Kushtetuta është e heshtur lidhur me atë se kush bën verifikimin e caqeve të imunitetit të gjyqtarëve kushtetues me qëllim që më pastaj të formohet një propozim për organin dekretues të gjyqtarëve kushtetues, siç është rasti me shkarkimin e tyre që diskutojmë në fund të këtij seksioni. Kjo heshtje në tekstin kushtetues u shpjegua më lartë. Ai duket si një lëshim teknik por i tillë nuk është ngaqë supozohet nga çdokush se cilat janë caqet e imunitetit funksional të gjyqtarëve kushtetues.[186] U mor vesh, përcaktimi i organit kushtetues që vendos për veshjen me imunitet, caqet dhe kushtet për heqjen e tij eventuale me qëllim të mospengimit të procedurave ligjore (administrative, penale, civile dhe kushtetuese), si dhe vënien në jetë të drejtësisë përbëjnë një rregull normale në vendet që u takojnë demokracive liberale kushtetuese.

Gjendja aktuale nuk nënkupton që në rastin e **Kosovës** duhet të ketë amulli sepse, **per analogiem**, lidhur me caqet e imunitetit duhet të vlejnë dhe zbatohen normat e njëjta që vlejnë për shkarkimin e gjyqtarëve kushtetues. Kjo qasje është e njëjtë me vendet tjera perëndimore, të cilat në mënyrë të qartë përcaktojnë organin kushtetues që vërteton caqet e imunitetit dhe kushtet për heqjen eventuale të tij. Në rastin e **Kosovës**, kjo nënkupton që, njëjtë si në vendet e demokracive kushtetuese të proveniencës perëndimore, **Gjykata Kushtetuese** duhet të prononcohet përmes propozimit lidhur me çdo kërkesë të organit zyrtar që kërkon të dijë caqet e imunitetit të gjyqtarëve kushtetues, në ndërkohë që dhënësi i imunitetit, **Presidenti i Republikës**, duhet ta ruaj fjalën e fundit ceremoniale për heqjen ose jo të imunitetit. Me fjalë të tjera, vendimi i **Gjykatës Kushtetuese**, i cili ka formën e propozimit për të cilin në fund formalizohet te **Presidenti i Republikës**, paraqet formën përcaktuese për caqet e imunitetit të gjyqtarëve kushtetues. Ai vendim duhet të merret me një shumicë të kualifikuar prej dy të tretave të votave të krejt gjyqtarëve kushtetues, sipas analogjisë me propozimin për shkarkim.[187] Kjo më tutje nënkupton se **Presidenti i Republikës** nuk mund të propozojë një zgjidhje të tretë apo një zgjidhje të vete autonome, pa pasur propozimin me shkrim të **Gjykatës Kushtetuese**, i cili duhet të jetë i arsyetuar dhe i qartë. Vetëm kjo e

[186] Në këtë drejtim, dispozitat kushtetuese lidhur me imunitetin funksional të gjyqtarëve të gjyqësorit të rregullt janë shumë më të qarta dhe më të sakta se ato që kanë të bëjnë me gjyqtarët kushtetues. Ato gjenden në nenin 107 ["Imuniteti"] të Kushtetutës. Fillimisht, në paragrafin e parë definohet imuniteti funksional në mënyrë të njëjtë siç bëhet për gjyqtarët kushtetues në dispozitën e nenit 117. Për dallim nga rasti i gjyqtarëve kushtetues, në paragrafin e dytë qartësohet se shkelja me qëllim e ligjit përbën një rrethanë që tërheq përgjegjësinë penale të gjyqtarit. Përveç kësaj, në paragrafin e fundit saktësohet se për arrestimin apo akuzimin e një gjyqtari duhet të njoftohet **Këshilli Gjyqësor i Kosovës**.

[187] Cf. fusnota nr. 273, **infra**, në këtë seksion, si dhe komentet tona që shkojnë me të.

fundit mund të bëjë propozim për caqet e imunitetit të një gjyqtari kushtetues, përfshirë heqjen e tij. Të njëjtin propozim duhet t'ia dërgoj **Presidentit të Republikës** për miratim.

Standardi sipas të cilit vetë gjykata kushtetuese, apo organi tjetër caqet e imunitetit të anëtarëve të të cilit duhet vërtetuar vendos në mënyrë autonome për caqet e imunitetit dhe heqjen e tij eventuale ekziston i mishëruar në shumicën e demokracive kushtetuese të botës. U mor vesh, një gjykatë kushtetuese nuk vendos **sua sponte**, me vetiniciativë, por gjithnjë sipas kërkesës së një organi publik që ka autorizim dhe interes ligjor për të vërtetuar caqet e imunitetit të gjyqtarëve kushtetues: në rastin e procedurave penale, një gjë të tillë duhet ta bëj organi i akuzës, kurse në procedurat civile dhe në procedurat tjera ligjore atë mund ta kërkojë vetë gjykata pranë të cilës ka filluar një procedurë e tillë ligjore, me kërkesën e palës në procedurë apo **sua sponte**, me vetiniciativë.

Përjashtimet nga kjo qasje janë të rralla dhe u diskutuan më sipër. Nuk e kemi fjalën këtu si përjashtim vetëm për vendet ish-komuniste, ku një gjë të tillë e ka kryer kuvendi si organ përfaqësues. Vlen të theksohet se ai organ, megjithatë, ka qenë organi që ka zgjedhur gjyqtarët (e rregullt dhe gjyqtarët kushtetues në ish-**Jugosllavi**). E pamë më sipër se edhe sot ka vende ku dhomat e caktuara të parlamentit apo parlamenti si tërësi vendos për rastet e imunitetit të gjyqtarëve kushtetues (**Argjentina, Cekia, Latvia, Rumania, Sllovenia, Ukraina**). Ai organ nganjëherë mund të jetë këshillit gjyqësor.[188] Ka raste kur këtë e bën shefi i shtetit (**Azerbajxhani**) apo një gjykatë speciale për **impeachement** të gjyqtarëve të lartë (**Norvegjia**).[189] Në sistemet presidenciale, siç është rasti me sistemin amerikan, për të cilin diskutojmë më poshtë në vijim, organi përfaqësues, **Kongresi Amerikan**, ka kompetencë për shkarkim dhe zhveshje nga imuniteti të gjyqtarëve, por vetëm për sa i përket çështjeve penale. Për çështjet civile, ata gëzojnë një **imunitet absolut**, diçka që sqarohet në vijim. Fjalën këtu e kemi vetëm për gjyqtarët federalë, kurse për gjyqtarët e shteteve anëtare të SHBA-ve nuk diskutojmë.

Si zgjidhje më e pranueshme në çështjet penale mund të paraqitet kombinimi imunitetit funksional me imunitetin procedural: asnjë procedurë penale nuk mund të ndërmerret, ndjekja penale në veçanti, pa heqjen e imunitetit të gjyqtarit kushtetues dhe gjyqtarit tjetër lidhur me veprat e kryera gjatë ushtrimit të funksionit gjyqësor. Ky kombinim konsiston në bashkimin e dy llojeve të imuniteteve, **imunitetit funksional** dhe **imunitetit procedural**. I pari është imunitet nga përgjegjësia penale dhe çdo përgjegjësi tjetër për aktet e ndërmarra dhe veprimet e shprehura si gjyqtar kushtetues dhe gjyqtar tjetër. Ky njihet ndryshe edhe si **non-liability immunity** apo **imuniteti (lirimi) nga përgjegjësia**). I dyti nënkupton që imuniteti mund të hiqet dhe të fillojë ndjekja penale vetëm pas analizimit të substancës së akuzave të ngritura nga organi i ndjekjes. Ky ndryshe njihet edhe si **inviolability immunity** apo **imuniteti i paprekshmërisë.** Këtë analizë e bën autoriteti kompetent shtetëror, përkatësisht dhënësi i imunitetit të gjyqtarit kushtetues apo të gjyqtarit tjetër të lartë që ushtron funksione të gjyqësorit kushtetues.[190] Një gjë e tillë përbën rrezik potencial për shpërdorim nga ana e personave të caktuar dhe mund të pengojë luftimin efektiv të korrupsionit. Këtë shqetësim e kanë shprehur edhe organet relevante evropiane, në veçanti kur flitet në kontekstin e vendeve ish-komuniste.[191] Ky kombinim i këtyre dy llojeve të imuniteteve, imunitetit funksional dhe imunitetit procedural, megjithatë, paraqet zgjidhjen dhe garancionin e vetëm aktualisht për mbrojtjen e pavarësisë së gjyqtarëve. Këtë konstatim e bazojmë edhe në faktin se hulumtuesit e çështjes së imunitetit kanë pasur mirëkuptim për imunitetin e paprekshmërisë kur ai është vënë në favor të gjyqtarëve të gjykatave të larta, përfshirë këtu gjyqtarët kushtetues.[192] Të shohim në vijim si rregullohet çështja e imunitetit të gjyqtarëve andej **Atlantikut.** Edhe atij bëhet dallim në mes të **imunitetit funksional** dhe **imunitetit të pa-**

---

188 Cf. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *The Composition of Constitutional Courts,* fq. 17

189 Ibid. fq. 18.

190 Group of States Against Corruption (GRECO), *Immunities of public officials as possible obstacles in the fight against corruption. Lessons learned from the three Evaluation Rounds (2000-2010) - Thematic Articles* (Council of Europe: Strasbourg, pdb) fq. 42-44. Në internet: https://rm.coe.int/16806cbfc6 (shikuar në prill 2018).

191 Ibid. fq. 41-46.

192 Ibid. fq. 45

prekshmërisë. Këtu flasim për të drejtën e brendshme. **Imuniteti diplomatik** është i njëjtë çdo kund nëpër botë dhe i takon të drejtës ndërkombëtare zakonore. Në përgjithësi, imuniteti diplomatik përbën një pengesë absolute për secilën fazë të procedurës penale.[193] Kjo përfshin edhe procedurën e dhënies së dëshmive: sipas pikë 2 të nenit 31 të **KVMD** agjenti diplomatik nuk mund të jep dëshmi.[194] I vetmi përjashtim nga **imuniteti diplomatik** janë procedurat ligjore në çështjet civile dhe administrative, saktësisht të specifikuara nga **KVMD.**[195] Ky imunitet mbulon edhe dhënien e dëshmisë në një procedurë ligjore. Si i tillë, **imunitet diplomatik** ekziston për diplomatët në planin bilateral, multilateral si dhe në rastin e misioneve **ad hoc** që organizohen për një rast të veçantë.

Një imunitet është absolut në **SHBA**, që korrespondon me kuptimin evropian të imunitetit të përgjithshëm (**imuniteti i paprekshmërisë**), atëherë kur plotësohen dy kushte: në rend të parë, gjyqtari duhet ta ketë ndërmarrë veprimin brenda fushës së juridiksionit të vet material dhe, së dyti, ai veprim duhet të ketë karakter të aktit gjyqësor. Në jurisprudencën amerikane, plotësimi i këtyre dy kushteve nënkupton që nuk mund të ushtrohen padi civile kundër gjyqtarëve që kanë kryer vepër penale me rastin e nxjerrjes së një akti gjyqësor në dëm të palës (viktimës), përfshirë rastet kur akti gjyqësor është nxjerrë përmes korrupsionit apo formave tjera të paligjshme. Kjo jurisprudencë në **SHBA** daton që nga rasti **Bradley v. Fisher** (1871).[196] Ky imunitet me caqe shumë të gjëra, në thelb, nuk ka ndryshuar që nga koha e paraqitjes së tij në jurisprudencën amerikane. Si i tillë, ai ka ekzistuar edhe gjatë kohës së kolonializmit britanik dhe ka lundruar në sistemin amerikan pas pavarësisë së SHBA-ve në vitin 1776. Në sistemin britanik, moto në të cilën është mbështetur ky imunitet amerikan ka qenë filozofia sipas së cilës **mbreti nuk gabon kurrë**. Kjo në esencë nuk ka ndryshuar as sot e kësaj dite: në **SHBA** aktualisht nuk ka përgjegjësi për vendimet e marra gjyqësore, përfshirë rastet kur ato janë marrë nën korrupsion dhe me maliciozitet. Thënë me fjalë të tjera, ani se një vendim mund të jetë marrë nën korrupsion apo me maliciozitet, pala e dëmtuar nuk ka të drejtë të nge padi ndaj gjyqtarit të tillë nëse plotësohen dy kushtet e sipërcekura: një, që ai vendim te ketë qenë marrë në kuadër të juridiksionit të gjyqtarit; dhe, dy, që të bëhet fjalë për vendim të natyrës së vendimit gjyqësor (pra mos të jetë një vendim administrativ, ta zëmë largimi nga puna i një punëtori, zvogëlimi i të ardhurave të punonjësve administrativ të gjykatës dhe kështu me radhë).

Në literaturën amerikane jepen tri arsye pse duhet të ekzistoj **imuniteti paprekshmërisë**: *e para*, thuhet se ky imunitet shërben për të mbrojtur gjyqtarët nga paditë fiktive për vendimet e marra gjatë kryerjes së detyrës zyrtare; *e dyta*, pohohet se **imuniteti paprekshmërisë** pengon shqetësimin e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrave të veta; dhe, *e treta*, ceket fuqishëm se ky lloj imuniteti nuk lejon që gjyqtari të vrapojë pas gjyqeve kundër tij në ndërkohë që duhet t'i kryejë detyrat si gjyqtar. Ky imunitet është i kualifikuar, apo funksional në kuptimin evropian, kur ka të bëjë me çështjet administrative të gjyqtarit, gjë që nënkupton se ai përgjigjet për gabimet e bëra **administrativo-teknike**, në mënyrë të njëjtë si çdo qytetar amerikan.[197] Në aspektet tjera imuniteti është **absolut** apo **i përgjithshëm**.

Sa i përket përgjegjësisë penale të gjyqtarit, nuk vlen **imuniteti absolut** ashtu gjyqtari nuk është i paprekshëm. Për këtë vlejnë procedurat e **impeachment**-it. Këtu ne flasim vetëm për **impeachment**-in e gjyqtarëve federalë sepse i njëjti parim vlen edhe për gjyqtarët më të ulët të gjykatave amerikane. Sipas seksionit të parë të nenit III të **Kushte-**

---

193 Neni 29 i **KVMD**: "Personi i agjentit diplomatik është i pacenueshëm. Ai nuk mund të arrestohet apo ndalet në asnjë formë dhe situatë. Shteti i pranimit e trajton atë me respekt dhe duhet të marrë të gjitha masat për të penguar çdo sulm ndaj personit të tij, lirisë apo dinjitetit"; Neni 31.1 i **KVMD**: "Agjenti diplomatik gëzon imunitet nga juridiksioni penal i shtetit pranues [...]".

194 Neni 31.2 i **KVMD:** "[...] Agjenti diplomatik nuk mund të dëshmojë."

195 Neni 31.1 i **KVMD**: "[...] Ai gëzon imunitet edhe nga juridiksioni civil dhe administrativ, përveç në rastet që kanë të bëjnë:
me një çështje civile që ka të bëjë me pasurinë e patundshme që gjendet në territorin e shtetit pranues, nëse një pasuri të tillë nuk e mban në emër të shtetit të dërgimit dhe për qëllimet e misionit;
me një çështje civile që ka të bëjë me trashëgimin në të cilën agjenti diplomatik është ekzekutues i një testamenti, administrator, trashëgimtar apo legatar në cilësi private dhe jo në emër të shtetit të dërgimit; dhe
me një veprim lidhur me aktivitetet profesionale apo komerciale të agjentit diplomatik në shtetin e pranimit jashtë funksioneve të tij zyrtare" [...]".

196 U.S. Supreme Court. Bradley v. Fisher, 80 U.S. 13 Wall. 335 335 (1871).

197 Në dy shkrimet në vijim, autorët japin në detaje historikun e krijimit të imunitetit absolut nga paditë civile të gjyqtarëve dhe angazhohen për heqjen e këtij imuniteti sepse viktimat e gjyqtarëve të kriminalizuar viktimizohen edhe më shumë përmes këtij imuniteti duke prishur barazinë para ligji të qytetarëve. Cf. **Brittney Kern,** "Giving New Meaning to "Justice for All": Crafting an Exception to Absolute Judicial Immunity" *Michigan State Law Review* Vol. 2014 Issue 1 (2014) fq. 149-185; Timothy M. Stengel, "Absolute Judicial Immunity Makes Absolutely No Sense: An Argument For An Exception To Judicial Immunity" *Temple Law Review* Vol. 84 No. 4 (Summer 2012) fq. 1071-1108.

tutës së SHBA-ve (1787), gjyqtarët federalë caktohen me mandat për tërë jetën e tyre me kusht që të shërbejnë siç u ka hije (**shall hold their Offices during good Behavior**). Kushtetuta nuk flet në mënyrë shprehimore për **impeachment**-in dhe largimin nga detyra të gjyqtarëve federal. Ata, megjithatë, bëjnë pjesë në kategorinë e zyrtarëve civil nga seksioni i katërt i nenit II të Kushtetutës, i cili përcakton si vijon:

"Presidenti, Zëvendës-presidenti dhe të gjithë Zyrtarët Civilë të Shteteve të Bashkuara do të largohen nga detyra pas **impeachement**-it dhe **dënimit** për tradhti, korrupsion, dhe krime e shkelje tjera të rënda".

Procedurat e **imepachment**-it dhe gjykimit ndahen në dy pjesë: e para pjesë fillon në **Dhomën e Përfaqësuesve të Kongresit Amerikan** kurse e dyta apo gjykimi pason dhe zhvillohet ndaras në **Senatin Amerikan**. Procedura e parë ka kuptimin e aktakuzës në kuptim të sistemit evropian, kurse e dyta e dyta ka kuptimin e një gjykimi në një gjykatë të themeluar me ligj sipas kuptimit evropian. Për nisjen e çfarëdo procedure ligjore kundër gjyqtarëve federalë, duhet që më parë të plotësohen dy kushte: një, lloji specifik i veprave penale, siç janë të përcaktuara në seksionin e katërt të nenit II të Kushtetutës; dhe, dy, duhet të zhvillohet një procedurë transparente në **Dhomën e Përfaqësuesve** të Kongresit para se të kaloj në gjykim në **Senat.** Në fazën e parë qartësohet çdo gjë rreth imunitetit penal të gjyqtarit. Nuk ka asnjë mundësi për ndjekje dhe largim të gjyqtarit federal pa ndjekur këtë procedurë të **imepachment**-it si më sipër.[198]

Këto ishin disa reflektime sa për të treguar shkarazi dallimin në mes të dy anëve të **Atlantikut** sa i përket imunitetit të gjyqtarëve dhe, **mutatis mutandis**, funksionarëve të tjerë federal. Ti kthemi tani diskutimit tonë rreth **Kosovës** dhe natyrës së imunitetit të gjyqtarëve kushtetues. Sikundër u pa, edhe Kushtetuta e SHBA-vë rri e heshtur sa i përket imunitetit të gjyqtarëve federal, kurse jurisprudenca amerikane këtë çështje e ka zgjidhur përmes analogjisë me statusin dhe imunitetin e funksionarëve federal, duke krijuar dy faza të vërtetimit të caqeve të imunitetit. Kjo jurisprudencë ka të bëjë vetëm me çështjet penale dhe asnjëherë nuk i referohet procedurave legale në lëmin civil ku imuniteti paraqitet si **imunitet absolut**.

Në vijim të këtij diskutimi, shënojmë se Kosova në tërësi ka ndjekur dhe përqafuar zgjidhjen e sipërcekur të propaguar nga **Komisioni i Venecias**. Kjo në veçanti ka qenë e rekomandueshme për demokracitë e reja të **ish-vendeve komuniste**. Nga vendet e demokracive tradicionale, vetëm **Italia** bën përjashtim sepse ofron **imunitet të paprekshmërisë** apo **imunitet absolut** për gjyqtarët e saj kushtetues. Sikur në **Kosovë** të ishte përqafuar modeli italian i imunitetit, shumë pak hapësirë do të ekzistonte për të bërë luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Kjo ka qenë arsyeja që edhe në të shumtën e rasteve, vendet ish-komuniste kanë dëgjuar rekomandimet e Komisionit të Venecias. Në këto vende, pas rënies së komunizmit dhe nisjes së proceseve demokratike, është vërejtur fenomeni i futjes në politikë, si deputetë dhe funksionarë të lartë shtetëror, i strukturave të kriminalizuara, të lidhura me krimin dhe nëntokën. **Kosova** në këtë kuptim nuk bën përjashtim. Vlerësimi i caqeve të imunitetit, përfshirë zhveshjen e këtyre strukturave nga imuniteti me të cilin ishin veshur duke shërbyer si funksionarë shtetëror në këto vende ka paraqitur një problem të madh, duke cenuar në këtë mënyrë barazinë e qytetarëve para ligjit dhe duke rezultuar në viktimizimin e dyfishtë të viktimave të krimit të **jakës së bardhë**. Për këtë arsye, me sa duket, **Komisioni i Venecias** ka insistuar në njohjen dhe garantimin vetëm të një lloji të imunitetit për gjyqtarët kushtetues dhe gjyqtarët e gjykatave të larta që ushtrojnë funksione të gjyqtarëve kushtetues - **imunitetit funksional**. Këtë e ka bërë qartë duke u deklaruar në mënyrë të fuqishme kundër njohjes së **imunitetit të paprekshmërisë** apo **imunitetit absolut**. Kjo qasje është bërë me qëllim të sigurimit të barazisë para ligjit të të gjithë qytetarëve dhe luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë.

Kur strukturat e krimit depërtojnë në nivele të larta, atëherë ato nuk respektojnë **imunitetin funksional** dhe asnjë lloj imuniteti tjetër kushtetues dhe ligjor. Kjo u vërtetua në rastin e autorit të parë të këtij libri, i cili u hetua, u akuzua dhe, pas

[198] Cf. më shumë për këtë dhe reagimet kritike të doktrinës që është kundër këtij imunizimi absolut të gjyqtarëve federal, në Saikrishna Prakash & Steven D. Smith, "Removing Federal Judges Without Impeachment" (FORUM) *The Yale Law Journal* Vol. 116 (2006-2007); James E. Pfander, "Removing Federal Judges". *The University oif Chicago Law Review* Vol. 74 No. 4 (Fall 2007) fq. 1227-1250; Seth Barrett Tillman, "Interpreting Precise Constitutional Text: The Argument for a "New" Interpretation of the Incompatibility Clause, the Removal & Disqualification Clause, and the Religious Test Clause—A Response to Professor Josh Chafetz's Impeachment & Assassination" *Cleveland State Law Review* Vol. 61 Issue 2 (2013) fq. 285-356 (autori diskuton të gjithë zyrtarët civilë, jo vetëm gjyqtarët federalë; kjo, megjithatë, nuk ndryshon esencën e çështjes që diskutojmë: këto dy procedura vlejnë për gjyqtarët federal ashtu që nuk ka asnjë rrugë tjetër alternative për nisjen e një procedure penale kundër një gjyqtari federal përveç duke respektuar dy fazat si më sipër).

një procedure gjyqësore që zgjati afër një vit e gjysmë, doli fitimtar nga të gjitha instancat gjyqësore. Objekt hetimi,[199] akuze[200] dhe i procedurës gjyqësore[201] kundër tij ka qenë ekskluzivisht vendimmarrja në rastin **KO 155/14** lidhur me

199 Hetimet fillimisht nisën më 14 prill 2015, kundër autorit të parë të librit dhe gjyqtares raportuese në rastin **KO 155/144,** znj. **Arta Rama-Hajrizi** Mandati i kryetarit të Gjykatës, autorit të parë të librit, ka mbaruar më 26 qershor 2015. Nga data 21 maj 2016 deri në mbarim të mandatit, ish-Kryetari i Gjykatës, autori i parë i këtij libri, ka qenë në pushim vjetor. Hetimi ka nisur për dy vepra penale: falsifikim i nënshkrimit dhe shpërdorim i detyrës zyrtare. Për ish-kryetarin e Gjykatës, autorin e parë të librit, **Hasani** ka pasur një akuzë shtesë, e cila katërcipërisht vërteton motivin thelbësor të aktakuzës dhe tërë procesit ligjor në kohën pas mbarimit të mandatit më datën 26 qershor 2015. Në atë pikë të vendimit për fillimin e hetimeve si më sipër, thuhet si vijon:
"[…] I pandehuri Enver Hasani: III. Në cilësinë e personit zyrtarë të kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, duke e shfrytëzuar në mënyrë të kundërligjshme pozitën dhe autorizimin zyrtar, me dashje direkte i tejkalon kompetencat e tij, ashtu që në kundërshtim me nenin 113 par.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 47 par.2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, pranon t'i shqyrtojë paditë e kandidatëve për kryeprokurorë në zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Shyqri Syla dhe Laura Pula, pa u vendosur për këto padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, dhe pa shterur mjetet juridike të përcaktuara me ligj, me ç 'rast ka nxjerrë Aktgjykim të kundërligjshëm me shenjen **Kl 100/04**, me të cilin e ka anuluar Vendimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, me shenjën KPK nr.146/2014, ku me dashje e ka dëmtuar të nominuarin e Këshillit Prokurorial, Z. **Aleksandër Lumezi** që të zgjidhet Kryeprokuror i Shtetit, me çka kishte për të kryer vepër penale: Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPK-së". Cf. **Republika e Kosovës/** Prokurori i Shtetit / Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës. **PPS. Nr: 18/2015**. Dt.14.04.2015. Prishtinë, fq. 2.
Paradoksi më i madh i tërë këtij rasti ka qenë që gjyqtari ndërkombëtar **Robert Carolan** ka qenë gjyqtar raportues në rastin e rrëzimit të Kryeprokurorit të Shtetit. Jo vetëm kaq! Prokuroria e Shtetit bën edhe një paradoks tjetër: duke qenë të paditur dhe deri në fund hakmarrës e arbitrar i referohen rastit si **Kl 100/04,** në ndërkohë që emërtimi i sakët i aktgjykimit me të cilin u anulua si jokushtetuese zgjedhja e **Kryeprokurorit të Shtetit** është rasti **KI 99/14 dhe 100/14**. Për të qenë kjo edhe më ironike, **Robert Carolan**, si gjyqtar raportues, do të shërbejë si dëshmitar i rrejshëm kundër ish-kryetarit të Gjykatës, autorit të parë të librit, ani se kishte fituar shuma të majme të rrogës dhe privilegjeve të tjera si pasojë e vazhdimit të mandatit të tij nga ana e ish-Presidentes **Jahjaga**. Ai sajoi rrejshëm tregimin mbi të a.q. vetëpërjashtim nga rasti **KO 155/14,** i cili ka vërtetuar se veprimet e ish-Presidentes **Jahjaga** kanë qenë në tërësi në harmoni me **Kushtetutën e Kosovës**. Ky gjyqtar, thënë ndryshe, ka shërbyer si një dëshmitar i rrejshëm në një rast penal kundër kolegut të tij, ish-kryetarit të Gjykatës, autorit të parë të librit, për gjoja falsifikim të nënshkrimit në rastin e vendimit ku ai ka përfituar shuma të majme me vazhdim të mandatit, askush tjetër. Fundja, edhe sikur Gjykata Kushtetuese të kishte thënë ndryshe, ata gjyqtarë ndërkombëtarë do të mund të rrinin në Kosovë në pozita të tjera, si këshilltarë ligjorë apo si punëtor të **EULEX**-it, në cilësi të tjera.
Gjykata Kushtetuese ka anuluar zgjedhjen e **Kryeprokurorit të Shtetit** për shkak të cenimit të nenit 31 të Kushtetutës lidhur me nenin 6 të **KEDNJ**. Me akuzat në këtë rast **Prokuroria e Shtetit** u bë interpretues i Kushtetutës, sikundër shihet nga formulimi absurd si më sipër ku organi i akuzës tregon se shkelja e nenit 113.7 të Kushtetutës përbën shkelje ligjore dhe vepër penale, ani se kryetari i Gjykatës Kushtetuese asnjëherë nuk vendos vetëm por së bashku me tjerët. Në këtë rast konkret, vendimi ka qenë unanim (njëzëri), kurse akuzat janë nisur vetëm ndaj kryetarit të Gjykatës, autorit të parë të këtij libri. Qëllimisht rastin **KI 99/14** dhe **100/04** nuk e shtjellojmë më në detaje, për t'ia lënë vetë lexuesit që ta analizoj rastin me ngadalë, i cili gjendet në ueb faqen e Gjykatës Kushtetuese. Ka rëndësi që lexuesi vetë të nxjerrë përfundimet në mënyrë autonome. Cf. më shumë për rastin e rrëzimit të **Kryeprokurorit të Shtetit** në: *Rastet KI 199/14 dhe KI 100/14. Aktgjykim. Parashtrues: Shyqyri Syla dhe Laura Pula. Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me procedurën e zgjedhjes se Kryeprokurorit te Shtetit*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Nr. ref.: A GJ 679/14. Prishtinë, 8 korrik 2014.
Ekziston edhe një arsye tjetër pse nuk e shtjellojmë në detaje rastin **KI 199/14 dhe 100/14**: në vitin 2017 **Gjykata Kushtetuese** sipas bazës së njëjtë kushtetuese dhe sipas procedurës tërësisht të njëjtë kishte anuluar zgjedhjen e kryetarit të **Gjykatës Supreme të Kosovës** dhe kryetarit të **Gjykatës së Apelit**. Nuk u nisën hetimet kundër askujt në Gjykatën Kushtetuese dhe asnjë akuzë nuk pati akuza! Në dy rastet, njëjtë si në rastin e **Kryeprokurorit të Shtetit**, **Gjykata Kushtetuese** edhe këtu kishte anuluar zgjedhjet për kryetar të këtyre dy gjykatave duke rikthyer çështjen në rivendosje në **Këshillin Gjyqësor të Kosovës**. U mor vesh, ky anulim ishte bërë, njëjtë si në rastin e Kryeprokurorit të Shtetit, pa pritur që kandidatët të shterin mjetet juridike para së të ushtronin ankesën kushtetuese sipas nenit 113.7 të Kushtetutës së vitit 2008 ! Cf. për dy këto raste, vendimet si vijon: *Rasti KI 47/17. Aktgjykim. Parashtrues: Valdete Daka. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK nr. 50/2017, të 6 marsit 2017*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref." AGJ 1092/17. Prishtinë, më 12 qershor 2017 (për rastin e anulimit të zgjedhjes së kryetarit **të Gjykatës Supreme të Kosovës**) dhe *Rasti KI 55/17. Aktgjykim. Parashtrues: Tonka Berisha. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit KGJ nr. 13/2017, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të 13 janarit 2017.* Gjykata **Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Nr. ref.: AGJ 1106/17. Prishtinë, 17 korrik 2017 (për rastin e anulimit të zgjedhjes së kryetarit **të Gjykatës së Apelit**).

200 Aktakuza është ngritur vetëm ndaj ish-Kryetarit, autorit të parë të librit, kurse hetimet nga gjyqtares **Arta Rama – Hajrizi** kanë pushuar pas zgjedhjes së saj kryetare e Gjykatës më datën 21 maj 2015 dhe marrjes së detyrës më datën 26 qershor 2015 (kur ish-Kryetari, autori i parë i librit, ka mbaruar mandatin). D.m.th. aktakuza është ngritur pas mbarimit të mandatit të autorit të parë si kryetar i Gjykatës, ani se asnjë provë e re, asnjë dëshmitar apo rrethanë e re nuk është shfaqur në ndërkohë (sic!). Dëshmitari i vetëm ngeli personi me **imunitet diplomatik**, ish-kolegu i kryetarit të Gjykatës, **Robert Carolan**, i cili kishte sajuar tregimin e rrejshëm për të a.q. vetëpërjashtim nga vendimmarrja në rastin **KO 155/14**, pasi kishte siguruar vazhdimin e kontratës dhe një rrogë të majme përmes dekretimit nga ish-Presidentja e Kosovës, **Atifete Jahjaga**. Cf. **Aktakuza e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës**, PPS nr. 18/2015 e datës 13 janar 2016.

201 Cf. vendimet e formës së prerë të dy instancave gjyqësore, të cilat i kanë dhënë të drejtë ish-kryetarit **të** Gjykatës, autorit të parë të librit, dhe kanë përdorur të njëjta argumente me te: **Aktvendim** PN. nr. 841/2016 i datës 22 dhjetor 2016 i **Gjykatës e Apelit e Kosovës** me të cilin hidhet poshtë Aktakuza në rastin e dëshmitarit të rrejshëm **Robert Carolan; Aktvendim** PML nr. 33/2017 i datës 28 mars 2017 i **Gjykatës Supreme të Kosovës**, me të cilin në tërësi vërtetohet aktvendimi i **Gjykatës së Apelit të Kosovës**. Në dy rastet, këto gjykata kishin theksuar se jo vetëm që bëhej fjalë për vendimmarrje që mbulohet në tërësi nga **imuniteti funksional**, por njëra nga to kishte shkuar më tej: **Gjykata Supreme e Kosovës** e kishte bërë të qartë se hetimet dhe ngritja e aktakuzës ndaj ish-kryetarit të Gjykatës, autorit të parë të librit, kishte qenë në tërësi **arbitrare** sepse fjala ka qenë për imunitet funksional dhe veprime tërësisht të ligjshme dhe rregullta ish-kryetarit të Gjykatës. Ky arbitraritet ka qenë i dukshëm edhe për faktin se dëshmia e dëshmitarit **Robert Carolan** është marrë në **kundërshtim** me ligjin ndërkombëtar dhe atë vendor që ka të bëjë me imunitetin diplomatik, përkatësisht që e ndalojnë një diplomat për të dhënë dëshmi pa e hequr imunitetin diplomatik nga dhënësi i tij, sipas kërkesës së autoriteteve zyrtare (cf. fusnotat nr. 193-195, supra, dhe fusnotën nr. 203, infra, si më dhe komentet tona që i shoqërojnë).
Sa i përket veprës penale, ndërkaq, dy gjykatat kishin thënë njëzëri se nuk bëhej fjalë as për kundërvajtje lëre më për vepër penale, kurse lidhur me përjashtimin **Gjykata Supreme e Kosovës** gjerësisht ka arsyetuar se ai mund të bëhet vetëm sipas procedurave ligjore dhe me vendim të Gjykatës Kushtetuese dhe se nuk ekziston asnjëherë instituti i **vetëpërjashtimit** të gjyqtarit në mënyrë autonome.

vazhdimin e mandatit të gjyqtarëve kushtetues ndërkombëtarë, i cili është diskutuar më sipër në këtë kapitull. Dëshmitar kryesor dhe i vetëm gjatë tërë këtij procesi skandaloz dhe arbitrar ka qenë njëri nga gjyqtarët kushtetues ndërkombëtar, **Robert Carolan**, i cili, paradoksalisht, vetë ka qenë përfitues i drejtpërdrejtë i një rroge të majme si pasojë e vazhdimit të mandatit nga ana e ish-Presidentes së Kosovës, **Atifete Jahjga**. Mënyrën se si është vazhduar mandati i gjyqtarëve kushtetues ndërkombëtarë e kemi diskutuar më sipër, duke provuar pafundësisht kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e tërë atij procesi.[202] Tani i kthehemi përshkrimit të rastit skandaloz kundër autorit të parë të këtij libri, që me siguri do të mbahet mend në analet e drejtësisë kosovare si një abuzim i hapur me detyrën zyrtare dhe si një përndjekje arbitrare për vendimmarrje gjyqësore në kundërshtim me të gjitha rregullat dhe standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare mbi **imunitetin funksional** dhe, kur është fjala për dëshminë e rrejshme të dëshmitarit kyç, gjyqtarit **Robert Carolan**, në kundërshtim edhe me standardet ndërkombëtare mbi **imunitetin e diplomatik**.[203]

Më datën 9 tetor 2014, ushtruesi i detyrës së Avokatit të Popullit, **Sami Kurteshi**, i cili pas mbarimit të mandatit të tij do të identifikohet si militant partiak i njërës prej partive opozitare kosovare të kohës, **Lëvizja Vetëvendosje (LVV)**, kishte bërë kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dekretit të ish-**Presidentes Jahjaga** për vazhdim të mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtar në Gjykatën Kushtetuese. Me vendimin e vet të sipërcekur në rastin **KO 155/14**, Gjykata e shpalli kërkesën e tij si qartazi të pabazuar. Siç e kemi shpjeguar më sipër, këtë kërkesë ushtruesi i detyrës së **Avokatit të Popullit** e kishte parashtruar vetëm nëntë ditë pasi gjyqtari ndërkombëtar **Robert Carolan** kishte fituar kontratën e tij nga **EULEX**-i dhe donatorët ndërkombëtar të Kosovës për një rrogë të majme, bazuar në dekretin e ish-**Presidentes Jahjaga**, dekret që ishte objekt i kontrollit të kushtetutshmërisë në rastin **KO 155/14.**[204] Pa u vonuar shumë, pas dështimit të parë, ushtruesi i detyrë së **Avokatit të Popullit** parashtroi kërkesën e dytë: në kërkesën e dytë, ai ndryshoi objektin e kërkesës. Tani kontestonte kushtetutshmërinë e vetë vendimit të Gjykatës në rastin **KO 155/14** (sic!). Kjo bëhej sepse, gjithnjë sipas tij, njëri nga gjyqtarët ndërkombëtarë, **Robert Carolan**, gjoja paskësh pas përjashtuar vetveten nga votimi në rastin në fjalë. Këtë tregim ia kishte thënë Avokatit të Popullit, vetë ai, duke treguar se si ai paskësh pas qenë prezent, por nuk paskësh pas marrë pjesë në votim sepse, gjithnjë sipas tregimit të tij, një gjë e tillë do të

---

202 Cf. seksionin 12.1, **supra**, ku përshkruhet në mënyrë të detajuar mënyra e vazhdimit të mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtar në **Gjykatën Kushtetuese**, e kryer ekskluzivisht nga ana e ish-**Presidentes Jahjaga** përmes letërkëmbimit me evropianët.

203 Neni 5.6 ["Privilegjet dhe imunitetet e misioneve diplomatike dhe konsullore dhe personelit të tyre"]:
"Personeli i misioneve diplomatike apo konsullore, përveç personelit të punësuar në vend, nuk do të kërkohet të jetë dëshmitar në procedura penale apo civile." **Ligji nr. 03/L-033 për statusin, imunitetet dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin e Kosovës dhe praninë ndërkombëtare ushtarake si dhe personelin e saj**. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* nr. 26, 02 qershor 2008 (Viti III) Prishtinë. Cf. edhe fusnotat nr. 193-195, supra, dhe fusnotën nr. 203, **infra**, si më dhe komentet tona që i shoqërojnë).

204 Cf. Aktvendimi në rastin **KO 155/14:**
" […] **Dekreti i sfiduar**
2. Parashtruesi i kërkesës sfidon Dekretin e Presidentes së Republikës së Kosovës për konfirmimin e vazhdimit të mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. DKGJK-001-2014, të 31 gushtit 2014 (në tekstin e mëtejmë: Dekreti).
Objekti i çështjes
3. Parashtruesi kërkon vlerësim të kushtetutshmërisë së Dekretit, duke pretenduar se ai është në kundërshtim me procedurën kushtetuese për zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të përcaktuar në nenin 114.2 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese], në nenin 65 (11) [Kompetencat e Kuvendit] dhe në nenin 84 (19) [Kompetencat e Presidentit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës [në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta].
4. Për më tepër, parashtruesi kërkon që Gjykata Kushtetuese e Republikës se Kosovës (ne tekstin e mëtejmë: Gjykata) [...] të vendosë masë të përkohshme për pezullimin e menjëhershëm të Dekretit të Presidentes deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës. Gjithashtu, parashtruesi kërkon që Gjykata të gjeje se "[...] *është në interes të publikut dhe demokracisë që tre gjyqtarët ndërkombëtarë të mos vazhdojnë të marrin pjesë në vendimmarrjen e kësaj Gjykate derisa të sigurohet kushtetutshmëria e emërimit të tyre."* […]."

përbënte konflikt interesi.[205] Vlen të theksohet se ky gjyqtar asnjëherë dhe në asnjë rast nuk kishte refuzuar dekretimin dhe nënshkrimin e kontratës së majme për rrogën e tij, akte këto që ishin me efekt të drejtpërdrejtë në konfliktin eventual të interesit, nisur nga fakti se rroga e tij e majme u rivazhdua më datën 1 tetor 2014 dhe nuk u ndal më kurrë deri në dorëheqjen e tij të dytë të detyruar. Në fakt, siç kemi treguar më herët, pikërisht për çështjen e kësaj rroge ai do të hetohet nga strukturat evropiane që luftojnë krimin e mashtrimit dhe dëmtimit të fondeve të **BE**-së, përkatësisht auditori **OLAF.**[206]

Me këtë deklaratë dhënë ushtruesit të detyrës së **Avokatit të Popullit**, gjyqtari **Robert Carolan** zbuloi një kategori dhe institut të ri, i cili në diskursin dhe praktikën juridiko-kushtetuese kosovare nuk kishte qenë i njohur asnjëherë. Në fakt, nuk kishte qenë i njohur asnjëherë në dy anët e **Atlantikut.** Fjalën e kemi për kategorinë dhe institutin e a.q. **vetëpërjashtimi gjyqtarit**. Kërkesa e dytë e **Avokatit të Popullit** e merrte si të mirëqenë se gjyqtari kushtetues, por edhe çdo gjyqtar i gjyqësorit të rregullt, mund të vetëpërjashtohej kurdo që donte dhe për këtë nuk kishte nevojë për një vendim të Gjykatës Kushtetuese (apo të kryetarit të një gjykate të rregullt, kur bëhet fjalë për **përjashtimin e gjyqtarit** në gjyqësorin e rregullt). E thënë ndryshe, vendimi i Gjykatës Kushtetuese (si dhe vendimi i kryetarit të një gjykate të rregullt kur flitet për gjyqësorin e rregullt kosovar) me të cilin konstatohet nëse ishin plotësuar kushtet për përjashtim të një gjyqtari ishte i panevojshëm sepse, sipas **Avokatit të Popullit** dhe vetë gjyqtarit ndërkombëtar **Robert Carolan**, një gjyqtar kurdo që dëshironte mund të vetpërjashtohej nga votimi dhe vendosja në një rast konkret. Instituti i vjetër i përjashtimit, aq sa vetë sistemi perëndimor i drejtësisë, që bën dallimin në mes të **iudex inhabilis** dhe **iudex suspectus**, u fshi nga faqja e dheut. Nuk kishte rëndësi për gjyqtarin **Robert Carolan** dhe **Avokatin e Popullit** se ky dallim i këtyre dy kategorive të përjashtimit përbënte një vlerë juridike civilizuese në vendet perëndimore në dy anët e **Atlantikut**. Kjo kategori ka rrënjë të thella mesjetare: është marrë nga juristët mesjetar të së drejtës romake për t'u bartur në modernitet e për të vazhduar jetën deri në ditët e sotme.[207]

---

[205] Cf. paragrafët në vijim te *Rasti KO 22/15. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës. Kërkesë për rishqyrtim të Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në Rastin K0155/14,të 13 nëntorit 2014.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.: RK792/15. Prishtinë, më 30 prill 2015, si vijon: "[…] **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës:**
20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i kontestuar për papranueshmëri K0 155/14 nuk ishte marre në pajtim me nenin 19 [Marrja e vendimeve], paragrafi 2, të Ligjit që përcakton se *"Gjykata Kushtetuese ka kuorum nëse janë të pranishëm shtatë* (7) *gjyqtarë".*
21. Duket se parashtruesi i kërkesës filloi një hetim ex *officio* lidhur me procedurat që çuan deri te Aktvendimi për papranueshmeri dhe, si përgjigje, gjyqtari **Robert Carolan** e informoi atë si në vijim: "*Nuk kam marrë pjesë në shqyrtimin ose në vendimin e Gjykatës sepse e kisha përjashtuar veten paraprakisht nga pjesëmarrja në shqyrtimin dhe vendimin e Gjykatës lidhur me Rastin K0 155/14.*"

[206] Cf. fusnotat nr. 30, & 80, **supra**, në këtë kapitull, si dhe fusnotën nr. 19 në **Kapitullin 11.**

[207] Dallimi në mes të këtyre dy llojeve të përjashtimit ekziston në çdo sistem juridik. Në rastin e **iudex inhabilis**, fjala është për situatat e përcaktuara qartë nga ligji të cilat në mënyrë absolute e bëjnë një gjyqtar të padenjë për të marrë pjesë në gjykimin e një rasti. Vendimi i gjykatës në këtë rast ka karakter deklarativ sepse vetëm konstaton përmbushjen e kushteve ligjore (siç janë gjinia e gjakut me palën, marrja pjesë në një gjykim të mëhershëm apo dëshmi, e cila paraqitet sërish për gjykim dhe vendosje para gjyqtarit të njëjtë dhe kështu me radhë). Në rastin e **iudex suspectus**, konflikti i interesit është relativ dhe ka të bëjë me rrethana të cilat ka gjasa të mëdha se mund ta cenojnë paanësinë dhe objektivitetin e gjyqtarit në gjykimin dhe vendosjen e rastit konkret. Në këtë rast, vendimi i gjykatë ska karakter konstitutiv dhe formon vetëm pengesën për gjykim dhe vendosje nga ana e gjyqtarit të tillë të përfshirë në një konflikt të tillë të interesit të konstatuar nga gjykata. Nga efekti i tyre juridik, vendimet si më sipër nuk janë të njëjta: shkelja e tyre në rastin e **iudex inhabilis** paraqet shkelje absolute të rregullave të procedurës dhe shkak për anulim të vendimit të marrë nga një gjyqtar i tillë, kurse në rastin e **iudex suspectus** fjala është për shkelje relative të rregullave të procedurës dhe gjykata nuk ka asnjë detyrim për vënien e tyre në syprinë nëse pala e afektuar nuk e ka ngritur një pengesë të tillë. Këtu e kemi fjalën për të gjitha procedurat ligjore, ato administrative, penale, civile dhe kushtetuese. Cf. *Ante Romac, Rječnik* latinskih *pravnih izraza.Vademecum iuridicum* (Informator: Zagreb, 1985) fq. 160-161;. Henryk Streit, "Iudex Suspectus czy Inhabilis? Studium przypadku". *Roczniki Wydziału Nauk Praënych i Ekonomicznych KUL*. Publisher: Towarzystwo Naukoëe KUL & Katolicki Uniëersytet Lubelski Jana Paëła II. Vol. 6 Issue 1 (*Prawo*) 2010, fq. 79-92 (ku autori flet për rëndësinë që kanë rregullat me të cilat përcaktohen a priori situatat që përbëjnë një pengesë të llojit iudex inhabilis dhe rolin e ligjvënësit në këtë drejtim; autori po ashtu thekson se nuk ka një paanësi dhe objektivitet ideal sepse gjyqtarët çdoherë jetojnë dhe i ndiejnë rrethanat sociale ku veprojnë dhe punojnë, mirëpo rëndësi të madhe ka që paraprakisht të vihen rregullat e qarta, normat e normave siç i quan autori, me të cilat lehtësoni vlerësimi i gjykatës për të bërë vlerësimin nëse ekziston një konflikt i interesit, duke mos ia lënë këtë vlerësim interesave të individualizuara të palëve dhe gjyqtarëve të rastit; autori në këtë kuptim bënë dallimin e qartë në mes të rastit të **iudex inhabilis** dhe rasteve të **iudex suspectus** si dhe efekteve të vendimeve në dy rastet dhe në të gjitha procedurat, ani se fokusi i këtij punimi është procedura penale; në rastin e **iudex inhabilis**, autori i venë në spikamë aspektet objektive të gjykimit që nuk varen nga gjyqtar: ato janë pengesa në aspektin e të vërtetës materiale që e bëjnë një gjyqtar të padenjë për të marrë një vendim në një rast konkret; në rastin e **iudex suspectus**, autori e vënë theksin të aspekti subjektiv, emocional dhe lidhmëria personale me palën dhe objektin e gjykimit dhe vendosjes).

Kjo reflektohet në secilin ligj organik mbi gjykatën kushtetuese, që rregullon organizimin, jetën dhe punën e gjykatave kushtetuese në nivel nacional, si p.sh. në **Austri,**[208] **Ceki,**[209] **Gjermani,**[210]**Itali,**[211]

---

[208] Cf. neni 12 (paragrafet 1deri 6) të **Ligjit mbi Gjykatës Kushtetuese të Austrisë** të vitit 1953 (me amendamentet e vitit 2016). *Constitutional Court Act 1953-VfGG*. Në internet: https://www.ris.bka.gv.at/ Dokument.ëxe?Abfrage = Erv& Dokumentnummer=ERV_1953_85 (shikuar në mars 2018). Paragrafi 2.1 i Ligjit si më sipër flet për kodin e procedurës civile si bazë për zbatim per analogiem në rast të zbrastësirave juridike procedurale, kurse në paragrafin e fundit të nenit si më sipër të këtij ligji theksohet se në të gjitha rastet e përjashtimit vendos vetë Gjykata. Situata e **iudex inhabilis** normohen me paragrafin 2. 1 & 2 kurse ato të **iudex suspectus** në paragrafin 2.3 që flet për "situatat tjera të rëndësishme që hedhin dyshim në paanësinë e tërësishme të gjyqtarëve".

[209] Në nenin 36, paragrafët 1-3 të **Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Çekisë** të datës 16 qershor 1993 rregullohen situatat e **iudex inhabilis**, kurse nenin 37 të të njëjtit ligj flitet për rastet e **iudex suspectus**. Dy rastet gjenden në seksionin që titullohet si **përjashtimi i gjyqtarit**, i cili ka vetëm dy nene. Dallimi në mes tyre shihet nga fakti se kërkesa për përjashtim të gjyqtarit nga neni 37 si më sipër, e bërë nga pala apo nga vetë gjyqtari, duhet të jetë e arsyetuar, kurse në rastet nga neni 36 nuk kërkohet asnjë arsyetim pos konstatimit se janë plotësuar rrethanat për përjashtim e që janë të natyrës objektive dhe nuk varen nga sjellja e gjyqtarit në të kaluarën apo në të tashmen. Për dy situatat vendos **Gjykata Kushtetuese** në përbërje të plotë, nëse rasti gjendet për vendosje pranë saj. Nëse rasti gjendet për shqyrtim dhe vendosje pranë kolegjit shqyrtues, atëherë një kolegj tjetër i radhës vendos për përjashtimin e gjyqtarit. Cf. *Constitutioanl Court Act of 16 June 1993* as amended by Acts No. 331/1993 Sb., 236/1995 Sb., 77/1998 Sb., 18/2000 Sb., 132/2000 Sb., 48/2002 Sb., 202/2002 Sb., 320/2002 Sb., 114/2003 Sb., 83/2004 Sb., 120/2004 Sb., 234/2006 Sb., 342/2006 Sb., 227/2009 Sb. 404/2012 Sb., and 275/2012 Sb. Në internet: https://www.usoud.cz/ fileadmin/user upload/ustavni soudwww/Pravniuprava /AJ/ Constitutional _court_ act _ 182_ 1993.pdf (shikuar në mars 2018).

[210] Neni 18 i **Ligjit të Gjermanisë për Gjykatën Kushtetuese** i vitit 1993 flet për ndalesën e gjyqtarëve për të marrë pjesë në gjykim dhe vendosje në rastet që i përgjigjen pengesave absolute, **iudex inhabilis**, kurse neni në vijim, neni 19, i përshkruan rrethanat që e bëjnë gjyqtarin të dyshimtë në paanësinë e tij, qoftë kur sfidohet nga ana e palëve apo vetëdeklarohet me dëshirë për një gjë të tillë, **iudex suspectus**. Ky ligj në vetëm në nenin 19 flet për vendimin e Gjykatës Kushtetuese Federale lidhur me përjashtimin, pra për rastet e **iudex inhabilis** nuk prononcohet fare sepse nënkuptohet se ato janë rrethana **ex lege** të cilat vetëm duhet të konstatohen dhe nuk kanë nevojë për një vlerësim të trupës gjykuese. Thënë me fjalë tjera, neni 199 bën fjalë për përjashtim me arsyetim dhe përfshinë vetëm situatat **iudex suspectus**, të cilat i nënshtrohen vlerësimit autonom të Gjykatës me qëllim të sigurimit se ekzistojnë rrethanat subjektive që besohet se mund të cenojnë rëndë paanësinë e gjyqtarit në një rast konkret. Cf. *Federal Constitutional Court Act* in the version of 11 August 1993 (Federal Law Gazette I p. 1473), last amended by Article 1 of the Act of 18 July 2017 (Federal Law Gazette I p. 2730). Në internet: http://www. bundesverfassungsgericht. de/SharedDocs/ Doënloads/ EN/Gesetze/ BVerfGG. pdf?blob=publicationFile&v=5 (shikuar në mars 2018).

[211] Në **Itali** bëhet po ashtu dallimi në mes të **iudex inhabilis** dhe **iudex suspectus**. Për të parin përdoret termi **astensione** kurs për të dytin **recusazione**. I pari ka kuptimin e abstenimit, përkatësisht mbulon situatat kur një gjyqtar ka pengesa absolute që e bëjnë të padenjë për të gjykuar në një rast. I dyti ka kuptimin e përjashtimit dhe ka natyrë të pengesës relative dhe mbulon rrethanat që mund ta vejnë në dyshim paanësinë e një gjyqtari dhe për këtë duhet një vendim i veçantë me të cilin arsyetohen rrethanat që e vejnë në dyshim paanësinë e gjyqtarit konkret. Këto dy institute, megjithatë, nuk gjejnë vend në gjyqësinë kushtetuese italiane: në këtë vend nuk ka dispozita kushtetuese apo ligjore që normojnë të **iudex inhabilis** (**astensione**) dhe **iudex suspectus (recusazione) në një proces gjyqësor kushtetues.** I vetmi përjashtim nga kjo rregull është gjykimi i funksionarëve të lartë shtetërore (presidentit, kryetarit të qeverisë dhe ministrave): vetëm në proceset kushtetuese penale, të njohur si **imepachmenet**, vlejnë rregullat e përgjithshme mbi **iudex inhabilis** dhe **iudex suspectus.** Kjo sepse, Parlamenti i Italisë e përpilon listën e gjyqtarëve që do të kryejnë një imeachmeent dhe në listën e tillë mund të shfaqen personat që kanë konflikt konkret interesi që shpërfaq pengesa të natyrës absolute apo relative. Në literaturën italiane, arsyeja përse as Kushtetuta në fuqi e vitit 1947 e as ligjet kushtetuese dhe ligjet e zakonshme që normojnë organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Italisë dhe të procedurave të saj, siç janë, ta zëmë, **la legge cost. n.1** i vitit 1948, **la legge n. 87** i vitit 1953 nuk parashikojnë rregulla si më sipër për procedurat kushtetuese ka të bëjë me natyrën e këtyre procedurave. Autorët italian thonë se që nga vitit 2008 është mënjanuar dispozitat që ka parashikuar këto dy institute sepse qëllimi primar i gjyqësisë kushtetuese italiane, përveç rastit të procedurave penale kushtetuese që kanë të bëjnë me impeaachement-in e presidentit, kryetarit të qeverisë dhe të ministrave, konsiston në ruajtjen dhe mbajtjen e rendit objektiv kushtetues që bazohet në sundimin e kushtetutës dhe ligjit, respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, ndarjen dhe balansimin e pushteteve dhe cilësi tjera si këto që e karakterizojnë demokracinë kushtetuese italiane. Në rastet jashtëzakonisht hipotetike, kur mund të ndodhë që një gjyqtarë ka pasur konflikt interesi në një rast, përjashtim atij të proceseve të impeachment-it, atëherë vlejnë rregullat për shkarkimin e gjyqtarit për shkak të shkeljes së rëndë të detyrave të punës. Kjo kështu pohohet nga autorët italian. Cf. më shumë rreth këtyre çështjeve si më sipër në: Gustavo Zagrebelsky, *La giustizia costituzionale*. (Il Mulino: Bologna, 1988) fq. 91-92; Alessio Rauti, "Riflessioni in tema di imparzialità dei giudici costituzionali". *Giurisprudenza costituzionale*, Vol. 54 No. 5 (2009) fq. 4020-4054; Veronica Magrini, *L'astensione e la ricusazione quali strumenti per la realizzazione dell'imparzialità del giudice costituzionale*. UNIVERSITÀ DI PISA DIPARTIMENTO DI GIURISPRUDENZA. Dottorato di ricerca in Scienze giuridiche-XXVI ciclo. CURRICULUM IN GIUSTIZIA COSTITUZIONALE E DIRITTI FONDAMENTALI, Coordinatore: Ch. mo Prof. Roberto Romboli (Giugno 2016), Disertacion i doktoratës, fq. 40-58, si dhe kapitullin e parë (ku autori flet për gjenezën historike të mungesës së këtyre dispozitave dhe arsyet që kanë të bëjnë me dallimin në mes të procesit (**processo**) dhe procedurës (**procedura**), përkatësisht në mes të dallimit të garantimit të të drejtave në sensin objektiv prej garantimit të të drejtave në sensin subjektiv. Vetëm në vendet ku ka një mbrojtje e të drejtave dhe lirive në sensin subjektiv mund të vijnë në shprehje institutet e abstenimit dhe përjashtimit, të përshkruara si më sipër. Në **Itali** kjo vjen në shprehje vetëm në rastin e proceseve të impeachment-it si më sipër); Gustavo Zagrebelsky & Valeria Marceni, *Giustizia costituzionale*. (Il Mulino: Bologna, 2012) fq. 134.

Kroaci,[212] **Poloni,**[213] **Shqipëri**[214] dhe kështu me radhë.[215] Këto ligje organike, jo rrallë, parashikojnë referimin në ligjet nacionale që rregullojnë procedurat ligjore (administrative, civile dhe penale) si bazë shtesë ligjore në rastet kur ligji organik për gjykatën kushtetuese nuk përmban norma të mjaftueshme për vlerësim të aspekteve procedurale të një rasti. Këtë e bën edhe **Ligji Nr. 03/L-121**, i cili lejon zbatimin, **per analogiam,** e ligjeve të caktuara procedurale të **Republikës së Kosovës**.[216] Këto ligje bëjnë këtë

---

[212] Në rastin e **Kroacisë**, ngjashëm me **Italinë**, ekziston vetëm një dispozitë ligjore që merret me iudex inhabilit: në nenin 27.6 ë **Ligjit Kushtetues mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kroacisë** përcaktohet se një gjyqtar ka të drejtë të mos merr pjesë në votim nëse ajo/ai ka marrë pjesë në miratimin e një ligji, rregulloreje apo vendimi tjetër që është objekt kontrolli kushtetues në Gjykatë. Në çdo rast tjetër, sipas po këtij neni, gjyqtarët janë të detyruar të votojnë. As **Rregullorja e Punës e Gjykatës Kuhstetuese të Kroacisë** nuk përmban asnjë dispozitë mbi **iudex inhabilis** apo **iudex suspectus.** Cf. *Ustavni zakon o Ustavnom sudu Republike Hrvatske* ("Narodne novine" broj 99/99., 29/02. i 49/02. - pročišćeni tekst). Në internet: https:// www.zakon.hr/z/137/Ustavni-zakon-o-Ustavnom-sudu-Republike-Hrvatske (shikuar në prill 2018); *POSLOVNIK USTAVNOG SUDA REPUBLIKE HRVATSKE* (pročišćeni tekst). Broj: SuT-A-6/2014 Zagreb, 26. svibnja 2014. Në internet: https://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/ 2014_07_83 _ 1623. html (shikuar në prill 2018).

[213] **Cf. neni 26.1 ["Iudex Inhabilis"] lidhur me ninin 26. 2 ["Iudex Suspectus"] i Ligjit mbi Tribunalin Kushtetues të Polonisë i datës 1 gusht 1997. Cf.** ***The Act of 1 August 1997 on the Constitutional Tribunal, Dz. U. No. 102, item 643, with d.*** **Në internet: https://palestrapolska.wordpress.com/2015/11/28/tk-iudex-suspectusiudex-inhabilis-przepisy-i-orzecznictëo/ (shikuar në masr 2018). Sipas nenit 26.3 të ligjit si më sipër, për rastin e iudex inhabilis vendos Kryetari i Tribunalit Kushtetues të Polonisë, kurse për iudex suspectus vendos Tribunali në përbërje të plotë.**

[214] Legjislacioni shqiptar ka një zgjidhje më të plotë sa i përket institutit të përjashtimit. Si shkaqe për përjashtim sipas nenit 36.1 të **Ligjit 8577** që normon organizimin dhe funksionimin e **Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë** paraqiten raste kur gjyqtari kushtetues:
a) ka marrë pjesë në hartimin e aktit objekt shqyrtimi;
b) ka deklaruar publikisht qëndrimin e tij ndaj çështjes;
c) për shkak të lidhjeve fisnore apo lidhjeve të tjera me pjesëmarrësit në gjykim vihet në dyshim paanshmëria e tij;
ç) paanshmëria e tij vihet në dyshim për shkaqe të tjera.
Sikundër shihet, kjo pikë e këtij neni përmbledhë në një vend shkaqet që mbulojnë situatat e konfliktit të interesit. Ato shkaqe mund të prodhojnë një konflikt absolut të interesit (**iudex inhabilis**) apo një konflikti relativ (**iudex suspectus**) të interesit. Të parat përshkruhen në pikën 1 nën "a", "b" dhe "c", kurse të dytat nën germën "ç ". Shprehja që përdoret për dy këto situata është heqja dorë nga shqyrtimi i çështjes. Në dy rastet, megjithatë, fjala është për institutin e përjashtimit të gjyqtarit për të cilin nevojitet një vendim i veçantë i Gjykatës Kushtetuese. Ky vendim, sipas nenit 37.2 të Ligjit nr. 8577, merret nga shumica e gjyqtarëve që marrin pjesë në shqyrtimin e çështjes. Sipas dispozitës së njëjtë, gjyqtari, për të cilin kërkohet përjashtimi, pasi dëgjohet nuk merr pjesë në votim. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, thuhet në këtë dispozitë, gjyqtari quhet i përjashtuar në vijim, dhe kryhet me shumicën e votave të atyre që janë prezent dhe votojnë. Neni 37 përcakton rastet kur gjyqtari që ndeshet me situatat nga neni 36 si më sipër nuk heq dorë nga shqyrtimi i çështjes dhe pala kërkon përjashtimin.
Në pikën 2 të nenit 36 ekziston një dispozitë shumë domethënëse që mbulon situatat në të cilat Gjykata Kushtetuese detyrohet të vendos për vetveten. Në këtë dispozitë qartë thuhet qartë se në rastet "[...] kur objekt shqyrtimi është një ligj ose akt normativ, i cili mund të ketë efekte edhe për gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese, heqja dorë e tij ose kërkesa për përjashtim për këtë shkak nuk pranohet".
Neni 16/a flet për situatën e papajtueshmërisë në të cilën mund të ndodhet një gjyqtar kushtetues gjatë ushtrimit të detyrës. në një rast të tillë, sipas këtij neni, ajo/ai menjëherë merr masa për shmangien e saj. Në rast të kundërt, gjejnë zbatim normat mbi përgjegjësinë disiplinore. Cf. Ligji nr. 8577, datë 10. 2. 2000 (ndryshuar me ligjin nr.99/2016) për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Në internet: http://www.gjk.gov.al/web/ligjperorganizimindhefunksionimingjykateskushtetuese 201 6 1667.pdf (shikuar në prill 2018).

[215] E njëjta vlen edhe për ligjet organike mbi gjyqësorin e rregullt, të cilat çdokund në vendet perëndimore normojnë dy llojet (kategoritë) e përjashtimit si më sipër. Në rastin **e iudex inhabilis**, përjashtimi kërkohet dhe bëhet **ex officio** kurse në rastin e **iudex suspectus**, përjashtimi kërkohet dhe bëhet me kërkesën e palës. U mor vesh, edhe vetë gjyqtari mund ta parashtroj çështjen e konfliktit relativ të interesit. Kjo nuk ndryshon asgjë: në rastin e iudex suspectus vetë gjykata vendos për përjashtimin duke vlerësuar nëse ekzistojnë rrethanat që e bëjnë të anshëm gjyqtarin ndaj rastit për të cilin duhet të gjykoj dhe vendos. Thënë ndryshe, në rastin e parë përjashtimi është automatik sepse rrethanat që përjashtojnë një gjyqtarë janë numëruar në mënyrë taksative me ligj, kurse në të dytin ai ndodh pas një vlerësimi të rrethanave të rastit konkret që kryhet nga ana e gjyqtarëve apo kryetarit të gjykatës, në vartësi të zgjidhjeve ligjore lidhur me organin vendimmarrës. Për **iudex inhabilis** në disa vende vendos kryetari i gjykatës kurse për **iudex suspectus** krejt trupa gjykuese. Në **Kosovë**, sikundër do të shihet, në dy raste vendos **Gjykata Kushtetuese**. Në gjyqësorin e rregullt, ndërkaq, kryetari i gjykatës vendos për përjashtimin e një gjyqtari, si në rastet e **iudex inhabilis** ashtu dhe në rastet e **iudex suspectus**.

[216] Neni 16.2 ["Rregulli i përgjithshëm"] i **Ligjit Nr. 03/L-121**: "[...] 2. Në rast të mungesës së dispozitave procedurale, Gjykata zbaton në mënyrë të arsyeshme dhe analoge dispozitat përkatëse të ligjeve tjera procedurale duke marrë parasysh natyrën e çështjes, si dhe veçoritë e procedurës para Gjykatës Kushtetuese."

dallim në mes të **iudex inhabilis** dhe **iudex suspectus.**[217] Në këtë aspekt, nuk duket që kanë ndonjë dallim thelbësor me dispozitat e **Ligji Nr. 03/L-121** mbi të njëjtën çështje,[218] dispozita që më tutje konkretizohen me **RP.**[219]

Ky qëndrim juridik i rrënjosur kaq shumë në kulturën juridike perëndimore nuk ka qenë i ditur nga gjyqtari **Robert Carolan** dhe ushtruesi i detyrës së **Avokati i Popullit**, të cilët besonin se vetë gjyqtari mund të vendosë se cilës kategori do t'i takojë, pra jo Gjykata Kushtetuese dhe gjyqtarët e saj në një përbërje të plotë, ashtu siç e përcakton **Ligji Nr. 03/L-121**, i cili në tërësi bazohet në standardet kushtetuese, ligjore dhe ndërkombëtare në dy anëve të **Atlantikut** lidhur me përjashtimin e gjyqtarëve. Nga formulimi i kritereve për përjashtim në këtë ligj, qartë shihet dallimi në mes të **iudex inhabilis** dhe **iudex suspectus**. **Ligji Nr. 03/L-121**, u mor vesh, nuk e bënë këtë dallim dhe nuk përmend një ndarje të tillë. Kjo i takon shkencës juridike, si në Kosovë ashtu dhe jashtë saj. Këtë e pamë më sipër në rastin e vendeve të caktuara evropiane, të cilat pak a shumë i ka ndjekur Kosova dhe **Ligji Nr. 03/L-121.** Të shohim tani si duket kjo në sistemin amerikan, gjithnjë duke u bazuar në standardin për përjashtim të gjyqtarëve të gjykatës së fundit në nivel nacional, e që në **SHBA nënkupton Gjykatën Supreme.** Kjo Gjykatë, siç e kemi sqaruar në kapitujt tjerë, ushtron, në të njëjtën kohë, edhe juridiksion kushtetues me efekt **erga omnes**.

Nuk ka asnjë dyshim që në sistemin gjyqësor të **SHBA**-ve, në mënyrë efektive bëhet dallimi në mes të **iudex inhabilis** dhe **iudex suspectus**. Ajo çfarë e dallon sistemin amerikan nga ai evropian (kontinental) konsiston në zgjidhjet procedurale për të arritur efektin e njëjtë: sigurimin e paanshmërisë dhe objektivitetit në një gjykim konkret. Të shohim si duket kjo para se të kalojmë në kërkesën e dytë të **Avokatit të Popullit** me të cilën kërkonte përjashtimin e autorit të parë të këtij libri, në ndërkohë që gjyqtari kushtetues ndërkombëtare **Robert Carolan** shpresonte se do të merrte një vendim të Gjykatës Kushtetuese më të cilën do të përligjte tregimin e vet të rrejshëm lidhur me të a.q. **vetëpërjashtim** nga gjykimi dhe vendosja në rastin **KO 155/14.**

---

[217] Tri ligjet sistemike procedurale kosovare kanë dispozita afërsisht të njëjta lidhur me përjashtimin e një gjyqtari në një proces konkret të natyrës administrative, civile apo penale. Shkaqet për përjashtim qartë ndahen në ato që i takojnë grupit të iudex inhabilis dhe që i takojnë grupit të iudex suspectus. Legjislacioni procedural civil i Kosovës, megjithatë, ka një dispozitë të veçantë sa i përpket përjashitmit: neni 69.1 nën "a" i **Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore** thekson, **inter alia**, se nuk është e lejuar kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit "me të cilën kërkohet përjashtimi i të gjithë gjyqtarëve të gjykatës që do të mund të gjykonin në një kontest të caktuar [...]." Kjo dispozitë qartë e bën të ditur atë që thuhet në këtë seksion lidhur me **përjashtimin në rrethanat e domosdoshmërisë**: kur të gjithë përjashtohen, askush nuk mund të përjashtohet. Kjo nënkupton se një gjykatë ka të drejtë të vendos lidhur me një çështje nëse kushtet dhe rrethanat e përjashtimit përfshijnë të gjithë gjyqtarët e asaj gjykate dhe nuk ka një instancë tjetër më të lartë se ajo për të vendosur apo zgjidhur çështjen e paraqitur pranë saj. Cf. dispozitat relevante të legjislacionit si vijon: Nënkapitulli III, nenet 29-31 ["Përjashtimi nga procedura administrative"] i **Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative**. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* / Nr. 20 / 21 qershor 2016, Prishtinë; Kreu III, nenet 67-71 ["Përjashtimi i gjyqtarit nga gjykimi"] i **Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën e Përgjithshme Kontestimore**. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* / Prishtinë: Viti III / Nr. 38 / 20 shtator 2008; dhe Kapitullit III, nenet 39-43 ["Përjashtimi i gjyqtarëve"] i **Kodit Nr. 04/L-123 të Procedurës Penale**. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* / Nr. 37 / 28 dhjetor 2012, Prishtinë; Cf. edhe fusnotat nr. **229-238**, **infra**, në këtë seksion, që diskuton rregullën e domosdoshmërisë në kontekstin amerikan.

[218] Neni 18 ["Përjashtimi i gjyqtarit"] i **Ligjit Nr. 03/L-121**:
"1. Gjyqtari përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurë sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës kur gjyqtari,
1.1. është i përfshirë në çështjen e cila është objekt i shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese;
1.2. është në lidhje martesore ose jashtëmartesorë ose në lidhje familjare më një palë në
procedurë, në pajtim me ligjin në fuqi; ose
1.3. sipas detyrës zyrtare është marrë më herët me çështjen para se ajo t'i jetë referuar Gjykatës Kushtetuese.
2. Gjykatësi nuk është i përfshirë në çështje në kuptimin e paragrafit 1, pika 1.1. vetëm pse i takon një grupi shoqëror ose gjinor, një profesioni ose një partie politike interesat e së cilës mund të preken nga
rezultati i procesit para Gjykatës Kushtetuese.
3. Paragrafi 1, pika 1.3. nuk përfshin pjesëmarrjen në procedurë legjislative si dhe shprehjen e mendimit profesional ose akademik për një çështje juridike, e cila mund të jetë me rëndësi për procesin para
Gjykatës Kushtetuese.
4. Vendimi për përjashtimin e gjyqtarit duhet të jetë i arsyetuar.
5. Gjyqtari i cili ka njohuri se plotëson të paktën njërin prej kushteve për përjashtim nga procedura, ka për detyrë ta njoftojë me shkrim Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese dhe të kërkojë përjashtimin e tij/saj nga procedura. Në këtë rast, paragrafët 3 dhe 4 zbatohen përshtatshmërisht."

[219] Cf. fusnota nr. 180, **supra**, si dhe komentet tona me të.

Çështja e skualifikimit të gjyqtarëve në kulturën perëndimore është e vjetër: përmendet në librat fetare, si në **Dhjatën e Vjetër** ashtu dhe në **Dhjatën e Re.**[220] Këto libra, megjithatë, kanë folur për shpërblimin që **Krijuesi** u jep gjyqtarëve që gjykojnë drejtë dhe në mënyrë të paanshme. Me kohë ka lindur nevoja që të krijohen rregulla konkrete juridike që do të normonin konfliktin e interesit dhe situatat tjera që mund ta vejnë në dyshim objektivitetin dhe paanësinë e gjyqtarit konkret. Ka qenë kultura juridike romake ajo që për herë të parë, përmes **Kodit të Justinianit**, ka ndërtuar norma juridike lidhur me skualifikimin e gjyqtarëve për shkak të konfliktit të interesit, jo si një dënim për mosgjykim të drejtë dhe të paanshme. Pas mbarimit të **Mesjetës**, juristët evropian e bartën këtë institut në të drejtën moderne evropiane në mënyrë graduale.[221]

Në sistemin e të drejtës së përgjithshme (**common law**), rregulla mbi skualifikimin e gjyqtarëve ka lindur në rastin **Dr. Bonham** (1602) dhe ka pasur të bëjë çdoherë me interesat financiare: në **Angli** nuk është lejuar skualifikimi i gjyqtarëve për shkak të paanëshmërisë por vetëm për faktin se gjyqtari ka pasur një interes financiar në rastin konkret. Esenca e rastit **Dr. Bonham**, në të cilin ka lindur dhe është krijuar standardi i të drejtës së përgjithshme (**common law**) mbi skualifikimin e gjyqtarit, konsiston në atë që **Bordi i Mjekëve të Kolegjit Mbretëror** ka dashur ta dënojë me gjobë dhe burg **Dr. Bonham**, i cili kishte ushtruar pa licencë profesionin e mjekut. Ky ka qenë konflikt i pastër i interesit sepse paratë nga gjoba kanë shkuar në xhepat e anëtarëve të **Bordit të Mjekëve të Kolgjit Mbretëror.**[222] Më vonë, në **SHBA** kjo rregull u ndërtua në rastin e njohur si **Tumey v. Ohio.**[223] Në këtë rast, gjyqtari paguhej në një përqindje nga gjobat e të dënuarve dhe kjo u cilësua si jo kushtetuese. Edhe në **SHBA** për një kohë të gjatë vetëm interesi financiar përbënte shkak për skualifikim të një gjyqtari. Vetëm më vonë u krijuan rregullat e qarta për skualifikim që nuk përfshinin vetëm interesat financiare të gjyqtarit, por çdo interes apo situatë që e vë në dyshim paanshmërinë dhe objektivitetin e gjyqtarit, absolut (**iudex inhabils**) apo relativ (**iudex supsectus**).[224]

Aktualisht ekzistojnë tri norma që sot janë në fuqi si standard i sakët lidhur me përjashtimin e gjyqtarëve federal në **SHBA**, në të gjitha nivelet e gjyqësorit. E kemi fjalën për normat nga seksioni **28 U.S.C. § 47** dhe **28 U.S.C. §§ 144 & 455** të **Kodit mbi Sjelljen e Gjyqtarëve i SHBA**. Norma e parë, **28 U.S.C. § 47**, thjeshtë kodifikon parimin sipas të cilit në apel rasti mund të gjykohet dhe vendoset vetëm nga dikush që nuk ka marrë pjesë në shkallën paraprake.[225] Norma e dytë, **28 U.S.C. §§ 144**, përmban kufizime më të ngushta dhe zbatohet vetëm ndaj gjyqtarëve të qarqeve federale dhe kërkon nga pala që me kohë të bëj një deklaratë nën betim në të cilën i paraqet faktet që janë të mjaftueshme për të krijuar anshmërinë e gjyqtarit.[226] Kjo mund të bëhet në secilën fazë të procedurës. Kjo, megjithatë, nuk do të thotë se gjyqtari duhet domosdo dhe me automatizëm të përjashtohet: faktet duhet të jenë të qarta dhe

---

220 Richard E. Flamm, The History of Judicial Disqualification in America". *The Judges' Journal* Vol. 52 No. 3 (2013) fq. 12-18 në 12.

221 Ibid. fq. 12-13.

222 Thomas McKevitt, ", The Rule of Necessity: Is Judicial Non-Disqualification Really Necessary? *Hofstra Law Review* Vol. 24 Issue 3 (1996) fq. -818-843 në fq. 820.

223 **Tumey v. Ohio**, 273 U.S. 510 (1927). U. S. Supreme Court. Në internet: https://supreme.justia.com/cases/ federal /us/273/510/case.html (shikuar në prill 2018).

224 Thomas McKevitt, "The Rule of Necessity: Is Judicial Non-Disqualification Really Necessary?, fq. 820 & 822.

225 **28 U.S. Code § 47** - Disqualification of trial judge to hear appeal:
"No judge shall hear or determine an appeal from the decision of a case or issue tried by him". (June 25, 1948, ch. 646, 62 Stat. 872.). Në internet: https://www.law.cornell.edu/uscode/text/28/47 (shikuar në prill 2018)

226 **28 U.S. Code § 144** - Bias or prejudice of judge:
"Whenever a party to any proceeding in a district court makes and files a timely and sufficient affidavit that the judge before whom the matter is pending has a personal bias or prejudice either against him or in favor of any adverse party, such judge shall proceed no further therein, but another judge shall be assigned to hear such proceeding.
The affidavit shall state the facts and the reasons for the belief that bias or prejudice exists, and shall be filed not less than ten days before the beginning of the term at which the proceeding is to be heard, or good cause shall be shown for failure to file it within such time. A party may file only one such affidavit in any case. It shall be accompanied by a certificate of counsel of record stating that it is made in good faith. (June 25, 1948, ch. 646, 62 Stat. 898; May 24, 1949, ch. 139, § 65, 63 Stat. 99.)." Në internet: https://www.law.cornell.edu/uscode/text/28/144 (shikuar në prill 2018).

bindëse. Norma e tretë, **28 U.S.C. §§ 455**, vlen për të gjithë gjyqtarët federalë dhe nuk kufizohet vetëm në rastet e paanshmërisë dhe paragjykimit personal (subjektiv).[227] Ne këtu nuk diskutojmë skualifikimin dhe përjashtimin e gjyqtarëve bazuar në rregullat e **Kodit të Etikës së SHBA**-ve, sepse, siç është vërejtur në literaturë, ato rregulla të etikës janë absorbuar në normat juridike të **Kodit të Sjelljes së Gjyqtarëve i SHBA.**[228]

Në ndërkohë që në normat nga seksioni 455 nën "a" dalin rrethanat që e vejnë në dyshim objektivitetin dhe paanshmërinë e gjyqtarit duke krijuar kështu prezumimin për të gjykuar deri sa mos të vërtetohet se ato rrethana ekzistojnë në mënyrë të arsyeshme, paragrafi nën "b" i normës nga seksioni 455 përmban përshkrimin e rrethanave që e detyrojnë një gjyqtarë për t'u skualifikuar nga gjykimi dhe vendimmarrja në një rasti konkret.[229] E parë nga standardi evropian i të drejtës kontinentale (civile), rasti i parë mund të

---

[227] **28 U.S. Code § 455** - Disqualification of justice, judge, or magistrate judge
"**(a)** Any justice, judge, or magistrate judge of the United States shall disqualify himself in any proceeding in which his impartiality might reasonably be questioned.
(b) He shall also disqualify himself in the following circumstances:
(1) Where he has a personal bias or prejudice concerning a party, or personal knowledge of disputed evidentiary facts concerning the proceeding;
(2) Where in private practice he served as lawyer in the matter in controversy, or a lawyer with whom he previously practiced law served during such association as a lawyer concerning the matter, or the judge or such lawyer has been a material witness concerning it;
(3) Where he has served in governmental employment and in such capacity participated as counsel, adviser or material witness concerning the proceeding or expressed an opinion concerning the merits of the particular case in controversy;
(4) He knows that he, individually or as a fiduciary, or his spouse or minor child residing in his household, has a financial interest in the subject matter in controversy or in a party to the proceeding, or any other interest that could be substantially affected by the outcome of the proceeding;
(5) He or his spouse, or a person within the third degree of relationship to either of them, or the spouse of such a person:
(i) Is a party to the proceeding, or an officer, director, or trustee of a party;
(ii) Is acting as a lawyer in the proceeding;
(iii) Is known by the judge to have an interest that could be substantially affected by the outcome of the proceeding;
(iv) Is to the judge's knoëledge likely to be a material witness in the proceeding.
(c) A judge should inform himself about his personal and fiduciaryfinancial interests, and make a reasonable effort to inform himself about the personal financial interests of his spouse and minor children residing in his household.
(d) For the purposes of this section the folloëing words or phrases shall have the meaning indicated:
(1) "proceeding" includes pretrial, trial, appellate Review, or other stages of litigation;
(2) the degree of relationship is calculated according to the civil law system;
(3)"fiduciary" includes such relationships as executor, administrator, trustee, and guardian;
(4) "financial interest" means ownership of a legal or equitable interest, however small, or a relationship as director, adviser, or other active participant in the affairs of a party, except that:
(i) Ownership in a mutual or common investment fund that holds securities is not a "financial interest" in such securities unless the judge participates in the management of the fund;
(ii) An office in an educational, religious, charitable, fraternal, or civic organization is not a "financial interest" in securities held by the organization;
(iii) The proprietary interest of a policyholder in a mutual insurance company, of a depositor in a mutual savings association, or a similar proprietary interest, is a "financial interest" in the organization only if the outcome of the proceeding could substantially affect the value of the interest;
(iv) Ownership of government securities is a "financial interest" in the issuer only if the outcome of the proceeding could substantially affect the value of the securities.
(e) No justice, judge, or magistrate judge shall accept from the parties to the proceeding a waiver of any ground for disqualification enumerated in subsection (b). Where the ground for disqualification arises only under subsection (a), waiver may be accepted provided it is preceded by a full disclosure on the record of the basis for disqualification.
(f) Notwithstanding the preceding provisions of this section, if any justice, judge, magistrate judge, or bankruptcy judge to whom a matter has been assigned would be disqualified, after substantial judicial time has been devoted to the matter, because of the appearance or discovery, after the matter ëas assigned to him or her, that he or she individually or as a fiduciary, or his or her spouse or minor child residing in his or her household, has a financial interest in a party (other than an interest that could be substantially affected by the outcome), disqualification is not required if the justice, judge, magistrate judge, bankruptcy judge, spouse or minor child, as the case may be, divests himself or herself of the interest that provides the grounds for the disqualification." (June 25, 1948, ch. 646, 62 Stat. 908; Pub. L. 93–512, § 1, Dec. 5, 1974, 88 Stat. 1609; Pub. L. 95–598, title II, § 214(a), (b), Nov. 6, 1978, 92 Stat. 2661; Pub. L. 100–702, title X, § 1007, Nov. 19, 1988, 102 Stat. 4667; Pub. L. 101–650, title III, § 321, Dec. 1, 1990, 104 Stat. 5117.). Në internet: https://www.law.cornell. edu /uscode /text / 28 /455 (shikuar në prill 2018).

[228] Thomas McKevitt, "The Rule of Necessity: Is Judicial Non-Disqualification Really Necessary?, fq. 827-829.

[229] Ibid., fq. 825-826.

cilësohet si **iudex suspectus** kurse i dyti si **iudex inhabilis**. Një normë tjetër me rëndësi është ajo nga neni seksioni 144 dhe, sikundër u pa, ka të bëjë me **iudex suspectus** vetëm sa i përket gjyqtarëve të qarkut. Norma nga seksioni 455, ndërkaq, përfshinë të gjithë gjyqtarët amerikan të të gjitha niveleve deri në **Gjykatën Supreme**.

Në rastet që mbulohen nga norma e seksionit 455 nën "a" fjala është për vlerësim kur skualifikimi nuk është i detyrueshëm sepse duhet të vlerësohet në tërësi objekti i gjykimit, cilësia dhe lidhshmëria e palëve me gjyqtarin, përkatësisht të vlerësohet nëse objekti dhe cilësia e palëve e bëjnë gjyqtarin të anshëm dhe paragjykues ndaj shqyrtimit dhe vendosjes së rastit.[230] Zbulimi i konfliktit të interesit në situata që mbulohen nga ky seksion paraqet një gjë shumë të vështirë sepse fjala është për animin personal dhe dukjen në sipërfaqe të një animi të tillë.[231] Se kjo është kështu qartë vërehet nga formulimi në pikën nën "e", i cili nuk lejon heqjen dorë nga kërkesa për përjashtim të gjyqtarit në rastet nga pika nën "a" e normës 455. Një gjë e tillë mund të ndodhë, sipas pikës nën "e", vetëm nëse konstatohen në procesverbal në mënyrë transparente të gjitha bazat për skualifikim nga pika nën "a" e normës si më sipër, përkatësisht nëse bëhet hapur e ditur se cilat janë arsyet konkrete të cilat mund ta vejnë në dyshim në mënyrë të arsyeshme paanshmërinë e gjyqtarit të rastit. Një gjë e tillë nuk mund të bëhet në situatat që mbulohen nga pika nën "b" e normës nga seksioni 455: në momentin që konstatohet se ekzistojnë rrethanat nga norma e seksionit 455 nën "b", gjyqtari i rastit duhet me automatizëm të largohet dhe të caktohet një gjyqtar tjetër. Situatat e tilla lehtë mund të vërtetohen, për dallim nga rastet e pikës nën "a" si më sipër.[232] Thënë me fjalë të tjera, normat nga seksionet 144 dhe 445 flasin për dy situata në të cilat gjyqtari mund apo duhet të përjashtohet, përkatësisht për shkak të konfliktit të interesit dhe anshmërisë apo dukjes në të pamë të ekzistimit të anshmërisë te një gjyqtar, si dy baza për përjashtim. Në rastin e konfliktit të interesit, përjashtimi është i garantuar dhe i detyrueshëm dhe rregullohet me seksionin 445 nën "b" (**iudex inhabilis**) kurse ato që janë si anshmëri apo si dukje e anshmërisë normohen me seksionin 455 nën "a" (**iudex suspectus**). Në situatat nga seksioni 445 nën "b" ekziston "detyra për të gjykuar dhe vendosur" kurse në situatat nga seksioni 144 dhe 445 nën "a" kjo detyrë shikohet në kuptimin relativ të rastit dhe cilësisë së palëve dhe i nënshtrohet një vlerësimi (nga palët apo nga vetë gjyqtari i rastit).[233]

Pyetja e pashmangshme që shtrohet në rastet e skualifikimeve dhe përjashtimit të gjyqtarëve ka të bëjë me atë se kush vendos për kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e përjashtimit: a është ai vetë gjyqtari që vendos, në mënyrë arbitrare pa asnjë kontroll nga askush, apo një instancë tjetër

---

230 Shkaqet e anshmërisë dhe joobjektivitetit të gjyqtarit, sipas jurisprudencës amerikane, duhet të jenë jashtë- gjyqësore. Ky fakt, ndër tjera, bën që ky shkak për përjashtim të ketë natyrë relative, pra të një marrëdhënie jashtëgjyqësore të gjyqtarit me palët dhe objektin e gjykimit. Të një natyre të tillë, do të ishin faktet siç janë, armiqësia e hershme me palën, diskutimi në publik i gjyqtarit për një çështje që më vonë bëhet objekt gjykimi dhe të ngjashme. Cf. Toni-Ann Citera, "A Look at the Extrajudicial Source Doctrine under 28 U.S.C. 455". *Journal of Criminal Law and Criminology* Vol. 85 No. 4 (Spring, 1995) fq. 1114-1135 (ku autori diskuton historinë e seksionit 455 nën "a" në dritën e jurisprudencës amerikane dhe vjen deri te përfundimi se dyshimi për paanshmërinë dhe objektivitetin e gjyqtarit nuk duhet të jetë subjektiv, qoftë në mendjen e gjyqtarit apo të vetë palës së afektuar; paanshmëria dhe objektiviteti i gjyqtarit si kusht për përjashtim duhet të kuptohet në sensin objektiv ashtu siç e sheh një vrojtues i jashtëm; këto konstatime të autorit vijnë nga analiza e tij e historisë legjislative të draftimit të normës nga seksioni 455 nën "a" dhe mënyrës si është zbatuar kjo normë në praktikë; kjo, megjithatë, nuk qëndron sepse, siç e pranon vetë autori, gjykata në rastet e përfshira nga seksioni 445 nën "a" analizon shkaqet jashtë-gjyqësore si faktor që mund të ndikojnë në paanshmërinë dhe objektivitetin e një gjyqtari).

231 Në situate të tillë, gjyqtari tjetër duhet të vendos dhe vendos për përjashtimin e gjyqtarit të sfiduar. Leslie W. Abramson, "Deciding Recusal Motions: Who Judges the Judges?". *Valparaiso University Law Review* Vol. 28 No. 2 (1994) fq. 543-561 në fq. 559-560.

232 Situatat nga pika nën "b" janë gjendjet e pastërta të konfliktit të interesit të cilat i ka përshkruar vetë ligjvënësi dhe nuk ekziston ndonjë vështirësi për t'i konstatuar. Këtu, thënë ndryshe, nuk flitet për anim apo anim që shpërfaqet (në dukje) nga gjyqtari konkret, rrethana që vështirë vërtetohen sepse çdoherë i referohen fakteve dhe ndodhive jashtë-gjyqësore (ekstra-gjyqësore), pra që kanë lindur jashtë kontekstit të gjykimit dhe vendosjes së një rast konkret. Në raste të tilla, po ashtu vendosja nga gjyqtari tjetër lidhur me përjashtimin bëhet edhe më e domosdoshme nëse kërkohet nga ana e palës. Cf. Leslie W. Abramson, "Deciding Recusal Motions: Who Judges the Judges?", fq. 560-561; Për faktet dhe rrethanat që kanë natyrë jashtë-gjyqësore dhe që potencialisht mund të ndikojnë në paanshmërinë dhe objektivitetin e gjyqtarit të rastit, cf. funosta nr. 230, **supra**, dhe komentet tona lidhur me te.

233 Cf. më shumë për këtë në Federal Judicial Center, *Recusal: Analysis of Case Law Under 28 U.S.C. §§ 455 & 144* (University Press of the Pacific, 2002) & Federal Judicial Center, *Judicial Disqualification: An Analysis of Federal Law* (144 (University Press of the Pacific, 2010).

gjyqësore më e lartë se gjyqtari që vendos nëse ajo/ai mund apo duhet të përjashtohet? Këtë e diskutojmë në vijim sepse përbën thelbin e çështjes **Robert Carolan** dhe narrativit të tij të rrejshëm mbi të a.q. vetëpërjashtim në rastin **KO 155/14**. Në vijim pason diskutimi lidhur me përvojat komparative në sferën e përjashtimit të gjyqtarëve, me qëllim të hedhjes dritë mbi këtë institut civilizues dhe kontrastimit të tij me veprimet skandaloze të gjyqtarit ndërkombëtar të Gjykatës Kushtetuese, **Robert Carolan**.

Në rastet kur të gjithë duhen skualifikuar, askush nuk skualifikohet.[234] Kjo thënie e njohur dhe shumë lakonike në jurisprudencën amerikane përbën thelbin e doktrinës së njohur mbi **rregullin i domosdoshmërisë** (**rule of necessity**). Sipas kësaj doktrine, kur të gjithë gjyqtarët duhen skualifikar si pasojë e **konfliktit absolut të interesit** apo kur mund të përjashtohen për shkak të paanshmërisë dhe paragjykimit të tyre (real apo të perceptuar), atëherë askush nuk skualifikohet apo përjashtohet nga gjykimi dhe vendosja e rastit. Në një situatë të tillë lejohet që vetë gjykata të vendos për rastin. Kjo bëhet vetëm atëherë kur nuk ekziston ligjërisht një gjykatë tjetër për të gjykuar në shkallë të fundit për skualifikimin apo përjashtimin. Kjo doktrinë bazohet në parimin e gjykimit të drejtë dhe të paanshëm sipas të cilit palët dhe publiku duhet domosdo të gëzojnë drejtën e një gjykimi lidhur me çështjen e tyre apo një çështje që paraqet interes për të gjithë. Me rastin e zbatimit të **rregullës së domosdoshmërisë** prezumohet se gjyqtarët kanë autorizim ligjor për një shqyrtim dhe vendosje të rasteve sepse supozimi paanshmërisë dhe objektivitet vepron në favorin e tyre.

Në rastet e nivelit federal në **SHBA**, kjo situatë nuk paraqet ndonjë problem sepse kryetari i **Gjykatës Supreme** vendos për caktimin e një gjyqtari tjetër apo një gjykate nëse vjen deri te skualifikimi apo përjashtimi i tërësishëm i nivelit të apelit federal.[235] Dilemat dhe vështirësitë paraqiten në një mënyrë të ashpër me rastin e gjykatave që janë pjesë e gjyqësorit jofederal në kuadër të shteteve anëtare, pra në rastet që gjykohen dhe vendosen nga gjyqësori që është pjesë e hierarkisë së gjykatave supreme të shteteve anëtare.[236] Kjo sepse për to nuk është kompetent kryetari i **Gjykatës Supreme:** në situatat kur duhet zbatuar **rregullën e domosdoshmërisë** në nivel të shteteve federale, guvernatori ose kryetari i gjykatës supreme të shtetit përkatës vendos për zëvendësimin e gjyqtarëve apo të gjykatës së skualifikuar, përkatësisht përjashtuar.

Kjo doktrinë për herë të parë ka lindur në **Angli** në vitin 1403,[237] por që me rastin **Dr. Bonham** ka marrë qytetarinë e plotë si koncept dhe si rregull. Në **SHBA** më pastaj ka gjetur vend në jurisprudencën

---

234 Cituar sipas Aaron S. Bayer, "The Rule of Necessity". *The National Law Journal*. Monday, April 23, 2007 fq. 1-2 në fq. 1.

235 28 U.S. Code § 291 - Circuit judges:
"**(a)** The Chief Justice of the United States may, in the public interest, designate and assign temporarily any circuit judge to act as circuit judge in another circuit upon request by the chief judge or circuit justice of such circuit.
(b) The chief judge of a circuit or the circuit justice may, in the public interest, designate and assign temporarily any circuit judge within the circuit, including a judge designated and assigned to temporary duty therein, to hold a district court in any district within the circuit." (June 25, 1948, ch. 646, 62 Stat. 900; July 28, 1953, ch. 253, § 2, 67 Stat. 226; Sept. 3, 1954, ch. 1263, § 39(b), 68 Stat. 1240; July 9, 1956, ch. 517, § 1(a), 70 Stat. 497; Pub. L. 85–755, § 2, Aug. 25, 1958, 72 Stat. 848; Pub. L. 95–598, title II, § 202, Nov. 6, 1978, 92 Stat. 2660; Pub. L. 97–164, title I, § 108, Apr. 2, 1982, 96 Stat. 28; Pub. L. 102–572, title I, § 104, Oct. 29, 1992, 106 Stat. 4507.). Në internet: https://www.law.cornell.edu/uscode/text/28/291 (shikuar në prill 2018).

236 Leslie W. Abramson, "Deciding Recusal Motions: Who Judges the Judges?", fq. 543-561 (autori shpjegon se në shumicën e shteteve dhe rasteve, vendimi për përjashtim lihet në diskrecion të vetë gjyqtarit të çështjes; kjo nuk bëhet në mënyrë arbitrare sepse gjyqtari i sfiduar duhet të jep deklaratë në procesverbal dhe, në fund të fundit, në instancën tjetër vendoset mbi meritat e një vendimi të tillë, përkatësisht nëse ai vendim i gjyqtarit ka qenë i drejtë; në disa shtete, kjo vendoset menjëherë nga kryetari i gjykatës së rastit dhe, pas kësaj, në apel sipas kërkesës së palës; në rastet tjera, gjyqtari i sfiduar ka të drejtë të vendos vetëm sa i përket plotësimit të afatit kohor për paraqitjen e kërkesës për përjashtim si dhe kushteve tjera formale; ka raste kur gjyqtari i sfiduar fare nuk vendosë për kërkesën rreth përjashtimit të tij por menjëherë e bartë atë të një gjyqtar tjetër; autori, në fund të këtij shkrimi mjaft analitik, përkrahë idenë se arsyet për përjashtim janë ato që në fund duhet të përcaktojnë identitetin e vendimmarrësit).

237 Në këtë rast, situata ka qenë kjo: u lejua që **Kancelari i Universitetit të Oksfordit** të vendos si gjyqtarë i paqes lidhur me rastin në të cilin vetë ai kishte qenë palë në procedurë. Kjo rregull u kodifikua në vitin 1743 më një ligj të **Parlamentit të Anglisë** që i lejonte gjyqtarët e paqes për të gjykuar dhe vendosur rastet edhe atëherë kur ata vetë ishin palë në procedurë. Cf. Thomas McKevitt, "The Rule of Necessity: Is Judicial Non-Disqualification Really Necessary?", fq. 829-830.

e **Gjykatës Supreme** në rastin e njohur si **Evans v. Gore** (1920).[238] Ky rast, për ironi të gjyqtarit kushtetues **Robert Carolan**,[239] ka pasur të bëjë pikërisht me sfidimin e ligjit për taksat në rrogat e gjyqtarëve të kësaj Gjykate dhe të gjyqtarëve të tjerë federalë. Në këtë rast, që si precedent nga atëherë nuk ka ndryshuar kurrë, instanca më e lartë gjyqësore në këtë vend ka konstatuar se e vetmja rrugë e ngelur ishte që rasti të shqyrtohej dhe vendosej, ani pse bëhej fjalë për rrogat e vetë gjyqtarëve të kësaj gjykate.[240] Kjo u bë sepse ndryshe do

---

238 **Evans v. Gore**, 253 U.S. 245 (1920). U. S. Supreme Court. Në internet: https://supreme.justia.com/cases/ federal/us/253/245/ (shikuar në prill 2018); Për komentet pro dhe kontra, cf. në shkrimet si vijon: I. S. B., "The Case for Reversal of Evans v. Gore" *Virginia Law Review* Vol. 25, No. 8 (Jun., 1939) fq. 975-981 (ku autori diskuton mundësinë e rishikimit më qëllim ndryshimi të precedentit të **Evans v Gore** në dritën e një vendimi të vitit 1939, me të cilin **Gjykata Supreme Amerikane** kishte hequr imunitetin nga taksimi të rrogave të punëtorëve federal; kjo, megjithatë, nuk ka ndodhur asnjëherë për gjyqtarët e kësaj gjykate ashtu që vendimi në rastin **Evan v Gore** ngel si precedent me fuqi **erga omnes** që nga ajo kohë); Thomas McKevitt, ", The Rule of Necessity: Is Judicial Non-Disqualification Really Necessary?, fq. 818-843 (ku autori në mënyrë të shkëlqyer flet për historinë e këtij instituti që nga shekulli i 15-të, rasti **Dr. Bonham**; sipas autorit fakt është që në kohët moderne rregulla e domosdoshmërisë zakonisht ka të bëjë me rastet e rrogave të gjyqtarëve dhe taksave të tyre; përkundër këtij fakti, pra se taksat në rrogat dhe vetë rrogat e gjyqtarëve në nivel nacional janë të involvuara si arsye për skualifikim të gjyqtarëve, **Gjykata Supreme**, në mbështetje të rregullës mbi domosdoshmërinë fuqishëm ka mbështetur fuqishëm imunitetin nga taksat të gjyqtarëve të kësaj gjykate; autori thekson se rregulla e domosdoshmërisë në SHB po zbatohet shumë gjerësisht dhe duket të kufizohet zbatimi i saj vetëm në rastet e skajshme dhe vërtetë të domosdoshme; këtë konstatim autori e arrin duke u bazuar jo vetëm në rritjen e rrogave të gjyqtarëve federal por edhe të punëtorëve të tjerë të administratës federale që janë të imunizuar nga taksat në rrogat e tyre).

239 Gjyqtari **R. Carolan** theksonte se ka konflikt interesi për shkak të rrogës që po merrte si pasojë e dekretit të ish-Presidentes **A. Jahjaga**, dekret që kishte qenë objekt i kontrollit kushtetues në rastin **155/14**, rast në të cilin ai gjoja ishte vetëpërjashtuar, kishte qenë prezent por nuk kishte marrë pjesë në votim. Ai, megjithatë, rrogën e majme nuk e kishte refuzuar ani se ishte "vetëpërjashtuar" (sic!). Cf. shtjellimet tona në seksionin 12.1, **supra**, në këtë kapitull.

240 Në rastin tjetër të vitit 1980 **United States v. Will,** në mënyrë edhe më të ashpër është zbatuar rregulla e domosdoshmërisë: **Gjykata Surpeme e Amerikës** ka vendosur që gjyqtarëve federal të qarkut të Illinoi-t t'u paguhet cent për cent në dollarë rroga e cila u takon sipas amendamentit III, ani se vetë gjyqtarët e Gjykatës Supreme ishin palë sepse edhe vetë rroga e tyre rritej me vendimin për të cilin po vendosin në favor të kolegëve të tyre të qarkut federal të Illinoi-t. Cf**. United States v. Will,** 449 U.S. 200 (1980). U. S. Supreme Court. Në internet: https://supreme.justia.com/ cases /federal/us/449/200/case.html (shikuar në prill 2018); Cf. edhe Mark S. Hurwitz, "Judges and the Rule of Necessity: *Ignacio* and the Ninth Circuit's Judges". *The Justice System Journal,* Vol. 28, No. 2 (2007) fq. 241-243 (ku autori citon një rast tjetër nga viti 1977, rastin **Atkins v. United States**, në të cilin bazohet rasti i sipërcekur **United States v. Will**).
Shumë vite më vonë, vetë **Gjykata Kushtetuese** do të ndeshet pikërisht me një situatë të njëjtë me rastin si më sipër amerikan, duke vepruar në mënyrë të drejtë pikërisht si gjyqtarët amerikanë të **Gjykatës Supreme** për rrogat e tyre, thjeshtë për arsye se bëhet fjalë për instancën e fundit në vend që ndan drejtësi dhe drejtësia duhet të ndahet çdoherë. E kemi fjalën për rastin e aktgjykimit të **Gjykatës Kushtetuese** lidhur me **rrogat** e vetë gjyqtarëve. Në fakt, në diskursin publik kosovar, ky aktgjykim njihet si **rasti i rrogave**. Në këtë aktgjykim, megjithatë, Gjykata në mënyrë të gabuar ka futur vetveten në kategorinë e institucioneve dhe agjensioneve të pavarura kushtetuese, në ndërkohë që ato paraqesin një pushtet të deleguar legjislativ ose ekzekutiv që ushtrohet nga trupat e ndryshëm administrativ. Ato asnjëherë nuk mund të cilësohet si organe që janë në ngarkesë për të kontrolluar kushtetutshmërinë, siç është **Gjykata Kushtetuese.** Në kuadër të kontrollit të kushtetutshmërisë, që në rend të parë nënkupton sigurimin e supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës, hyn edhe kontrolli i akteve juridike dhe veprimeve të tjera të pushteteve të deleguara ligjvënëse e ekzekutive tek agjencitë dhe institucionet e pavarura kushtetuese. Thënë me fjalë të tjera, **Gjykata Kushtetuese** nuk bën pjesë në asnjërin prej tri pushteteve klasike dhe nuk është pushtet i deleguar, por një pushtet i konstituuar (**pouvoirs constitués**), njëjtë si të tjerat, por, për dallim prej të tjerave, ka monopol ekskluziv për interpretimin përfundimtar të kushtetutshmërisë me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së normave kushtetuese, letrës dhe shpirtit të tyre. Të njëjtin gabim, **Gjykata Kushtetuta** e ka bërë në një vendim tjetër të vitit 2016, kur kishte futur vetveten në kategorinë e institucioneve dhe agjencioneve të pavarura, pra si pushtet i deleguar, që asnjëherë nuk bëjnë pjesë në kategorinë e njëjtë me **Gjykatën Kushtetuese** për arsyet e sipërcekura.
Për të përmbledhur më fund, ajo që ka rëndësi për situatën që diskutojmë, është se në këto dy aktgjykime **Gjykata Kushtetuese** ka vendosur për vetveten, për rrogat e vetë gjyqtarëve kushtetues, në mënyrë të njëjtë si në rastet e sipërcekura në **SHBA**, **Shqipëri** dhe gjetiu. Kjo është arsyeja pse këtu ka ardhur deri te vënia në jetë e **rule of necessity**: nuk ka mund të vijë deri te përjashtimi i askujt në Gjykatë sepse të gjithë është dashur të përjashtohen meqë fjala ka qenë për **rrogat** e tyre. Pra fjala ka qenë për konflikt absolut të interesit që ka përfshirë të gjithë gjyqtarët kushtetues. Sikur të vinte deri te përjashtimi i Gjykatës Kushtetuese, atëherë një gjë e tillë do të thoshte se një akt juridik i organit ekzkeutiv për rritjen e rrogave përjashtohej nga kontrolli kushtetues i Gjykatës për shkak të konflikti të përgjithshëm të interesit. Një gjë e tillë nuk është në interesin publik dhe, për pasojë, nuk mund të vijë deri të përjashtimi i gjyqtarëve kushtetues. Kjo për shkak se më shumë rëndësi ka që të dihet nëse akti i organit ekzekutiv kosovar është i përlyer me jokushtetutshmëri dhe kjo është detyrë e Gjykatës Kushtetues dhe e askujt tjetër. Në këto dy raste nga praktika e Gjykatës ka ardhur në shprehje me tërë fuqinë e vet prezumimi i paanshmërisë dhe objektivitetit të gjyqtarëve kushtetues, për shkakun e thjeshtë se nuk ka ekzistuar dhe nuk ekziston askush tjetër që të vendos për këtë çështje: **shteti asnjëherë nuk guxon të bllokohet për shkak të konfliktit të përgjithshëm të interesit në shkallën e fundit**. Cf. më shumë për këto dy aktgjykime dhe shtjellimet e gabuara të Gjykatës lidhur me vendin dhe pozitën e institucioneve dhe agjencioneve të pavarura dhe ngatërrimin e tyre me vetveten në: *Rasti KO 73/16. Aktgjykim. Parashtrues: Avokati i Popullit. Vlerësim i kushtetutshmërisë se Qarkores Administrative nr. 01/2016, të nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike të Republikës së Kosovës, me 21 janar 2016.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtinë. Datë: 8 dhjetor 2016 Nr. ref.: AGJ 1015/16. Paragrafët: 76-83, 87-89-92-96 (për më tepër, në paragrafin 92 Gjykata flet për vetveten si për një organ i pushtetit gjyqësor, për të vazhduar pas këtij paragrafi deri në fund të analizës së meritave të rastit në paragrafin 96 me trajtimin e vetvetes si pjesë e organeve e institucioneve tjera të pavarura, në veçanti duke krahasuar vetveten me **Avokatin e Popullit** dhe **Auditorin e Përgjithshëm**); *Rasti K0 12/18. Aktgjykim. Parashtrues: Albulena Haxhiu dhe 30 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 04/20, te 20 dhjetorit 2017.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë. Datë: 11 qershor 2018 Nr. ref.: AGJ 1258/18. Paragrafët: 85-87, 91, 104 & 113.

të cenohej një interes madhor: nuk do të ishte në interes publik që çështja të ngelej pezull dhe mos të dihej kushtetutshmëria ligjit për taksat në rrogat e gjyqtarëve në nivel nacional amerikan.

Mjaft universal doli të jetë rasti i sipërm i Gjykatës Supreme të SHBA-së, aq sa, gati një shekull më vonë, në Shqipëri u testua qëndrueshmëria e tij. E kemi fjalën për prononcimin e **Komisionit të Venecias** në rastin e **vetingut shqiptar**, kur konstatoi se nuk mund të bëhej vetëpërjashtimi apo përjashtimi i gjyqtarëve kushtetues të **Shqipërisë**. Për shkak të interesit publik, u tha nga Komisioni, Gjykata Kushtetuese kishte mandat të plotë për të gjykuar dhe vendosur lidhur me të gjitha situatat rreth vetingut ku përfshiheshin vetë gjyqtarët e kësaj gjykate.[241] Deri te një konstatim i ngjashëm kishte ardhur Komisioni edhe në rastin e dhënies së mendimit të vet lidhur me ligjin shqiptar për **lustrimin e figurave publike**: atëherë kishte theksuar se asnjëherë asnjë ligj nuk mund t'i shmanget kontrollit kushtetues sipas kritereve dhe procedurave të parashikuar me kushtetutë dhe ligje. Kjo nënkuptonte se, në rastet kur një gjyqtar apo disa prej tyre duheshin t'i nënshtroheshin lustrimit, një gjë e tillë nuk do t'i pengonte ata për të marrë pjesë në gjykimin dhe vendosjen lidhur me kushtetutshmërinë e ligjit për lustrimin.[242] Kjo sepse kontrolli kushtetues i ligjeve paraqet një interes publik shumë më të lartë që rri përmbi çdo interes tjetër të gjyqtarëve.[243]

Shikuar në aspektin filozofik, **rregulla mbi domosdoshmërinë**, që nënkupton mandatin e një gjykate apo organi shtetëror në shkallë të fundit në nivel nacional për të vendosur për vetveten edhe atëherë ku ekziston një konflikt i hapur interesi apo kur mund të vihet në pyetje paanshmëria dhe objektiviteti i organit, ka rrënjët e veta në teorinë gjermane të gjysmës së dytë të shekullit XIX. Në këtë kohë, **Fredrik Karl von Savinji** (***Friedrich Carl von Savigny***: 1779 – 1861), një përkrahës i teorisë individualiste mbi subjektet e së drejtës, arriti të zhvendosë debatin e kohës lidhur me personalitetin e shtetit si subjekt i së drejtës, nga një debat për natyrën e shtetit si person juridik në një debat për atributet (cilësitë/kompetencat) e shtetit si subjekt i pavarur i së drejtës. **Me këtë, subjektiviteti dhe personaliteti i shtetit si person juridik paraqitej si i ndarë nga subjektivitetit dhe personaliteti i atyre që përfaqësojnë shtetin.**[244] Ky debat më pastaj u bart në truallin amerikan në fillim të shekullit '20-të: fillimisht ka pasur të bëj kryesisht me natyrën juridike të subjekteve jo-shtetërore me identitet korporatist, gjithnjë duke u mbështetur në konceptin gjerman lidhur me subjektet e së drejtës.[245] **Cilësitë apo kompetencat e shtetit (atributet) si subjekt juridik janë ato që e dallojnë shtetin nga shoqëria duke e bërë atë bartës të të drejtave dhe detyrimeve dhe, për pasojë, subjekt të përgjegjësisë ndaj të tjerëve**. Ky subjektivitet shtetëror mundëson që të krijohet një fiksion

---

241 European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Albania. **Amicus Curiae Brief** for the Constitutional Court on the Law on Transitional Evaluation of Judges and Prosecutors (the Vetting Law).* **Strasbourg**, 12 December 2016. **Opinion No. 868/2016. CDL – AD (2016) 036**. Original: English. Paragrafët 17 25. Në internet: http://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)036-e (shikuar në prill 2018).

242 European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), ***Amicus Curiae Brief.*** *Opinion on the Law on the Cleanliness of the Figue of High Functionaries of the Public Administration and Elected Persons of Albania.* **Strasbourg**, 13 October 2009. **Opinion no. 524/2009. CDL-AD (2009) 044**. Original: English. Paragrafet 142-143 & 145. Në internt: http://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/?pdf=CDL-AD(2009)044-e (shikuar në maras 2018).

243 Ibid. paragrafi 143: "[…] Në një situatë të tillë, qëllimi për të ikur nga situata ku Gjykata do të bllokohej nga gjykimi dhe vendosja lidhur me kushtetutshmërinë e një ligji është më i lartë (superior) se çdo interes tjetër që ka të bëjë me gjyqtarët dhe çështjet tjera (shih, *mutatis mutandis* Venice Commission, Opinion on two draft laws amending Law no. 47/1992 on the organisation and functioning of the Constitutional Court of Romania, CDL-AD(2006)006, § 7)."

244 Cf. më shumë në Andreas Rahmatian, "Friedrich Carl v. Savigny's 'Beruf" and 'Volksgeistlehre'." *Journal of Legal History* Vol. 28 No. 1 (2007) fq. 1-29; Janne E. Nijman, "Non-State Actors and the International Rule of Law: Revisiting the "Realist Theory" of International Legal Personality". Në Math Noortmann and Cedri Ryngaert (eds.), *Non-State Actor Dynamics in International Law: From Law-Takers to Law-Makers* (ASHGATE: England, 2010) fq. 91-119 në fq. 112-113; Augusto Zimmermann, "The 'Darëin' of German legal theory—Carl von Savigny and the German School of Historical Law" *Journal of Creation* Vol. 27 No. 2 (2013) fq. 105-111; Elvia Arcelia Quintana Adriano, "The Natural Person, Legal Entity or Juridical Person and Juridical Personality". *Penn State Journal of Law & International Affairs* Vol. 4 No. 1 (2015) fq. 364-391 në fq. 369, 371, 373, 379-380.

245 Arthur W. Machen, Jr., "Corporate Personality" *Harvard Law Review* Vol. 24, No. 4 (Feb., 1911), fq. 253-267 në fq. 254-257; John Dewey, "The Historic Background of Corporate Legal Personality" *Yale Law Journal* Vol. 35, No. 6 (1926) (ku autori përshkruan në mënyrë të shkëlqyeshme se subjektet e së drejtës janë koncepte të teorisë gjermane që kanë lindur mbi bazën e analizës të së drejtës romake, si dhe analizës së organizimit të brendshëm kishtar mesjetar dhe rolit të **Kishës Katolike** ndaj entiteteve që nuk kanë qenë njerëz; autori thekosn se entitetet juridike janë koncepte që mëtojnë lokalizimi e vendit ku gjenden të drejtat dhe detyrimet dhe bartësit apo titullarët e tyre; me këtë, autori bën dallimin në mes të identitetit korporatist të një subjekti të së drejtës dhe identitetit të vetë individëve që punojnë në te apo flasin në emër të entitetit të tillë korporatist). Martin Petrin, "Reconceptualizing the Theory of the Firm -From Nature to Function". Penn. State Review Vol. 118 No. 1 (Summer, 2013) fq. 1-55 në fq. 4-6 & 8-9.

i paanësisë dhe objektivitetit të gjithë atyre që veprojnë në emër të shtetit në shkallë të fundit. Kjo është kështu sepse shteti përgjigjet për oficerët e vet dhe për të gjitha organet që përbëjnë personalitetin juridik të shtetit. Ndryshe, shteti do të bankrotonte dhe do të bllokohej nga mosvendosja për shkak të skualifikimeve apo situatave të tjera të dukjes së paanësisë dhe mungesës së objektivitetit në vendosje dhe gjykim nga ana e oficerëve të shtetit – gjyqtarëve dhe të tjerëve që vendosin në shtet.

Të shohim tutje si u shpërfaq kjo praktikë civilizuese perëndimore lidhur me përjashtimin e gjyqtarëve kushtetuese dhe gjyqtarëve të tjerë si oficer të shtetit, gjithnjë në dritën e skandalit të gjyqtarit ndërkombëtar në Gjykatën Kushtetuese, **Robert Carolan**. Vazhdojmë diskutimin.

Kërkesën e dytë të **Avokatit të Popullit**, Gjykata e hudhi poshtë si qartazi të pabazuar.[246] Kjo sepse kërkesa, sipas Gjykatës, nuk ngriste asnjë çështje me relevancë kushtetuese në kuadër të kompetencave të **Avokatit të Popullit.**[247] Në të njëjtën kohë, Gjykata ia rikujtoi **Avokatit të Popullit** se tanimë ajo kishte vendosur për rastin e dekretit të ish-**Presidentes Jahjaga** në rastin **KO 155/14**.[248] Së bashku me kërkesën e tij, **Avokati i Popullit** kishte kërkuar përjashtimin e ish-**Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese**, autorit të parë të këtij libri, kërkesë të cilën Gjykata e kishte refuzuar njëzëri.[249] Gjyqtari **Robert Carolan** kishte kërkuar përjashtimin nga rasti sipas kërkesës së dytë të **Avokatit të Popullit**, me shpresë së do të përligjsonte vetëpërjashtimin fiktiv të tij nga rasti i parë i **Avokatit të Popullit**, rasti **KO 155/14.** Sikundër është theksuar, gjyqtari kushtetuese ndërkombëtar, **Robert Carolan**, pasi kishte marrë kontratën

246 Aktvendimi në rastin **KO 22/15**, paragrafi 65.

247 Aktvendimi në rastin **KO 22/15**, paragrafët si vijon:
"[…] 29. Sidoqoftë, kjo ankesë nuk hyn në fushëveprimin e kësaj dispozite kushtetuese, siç mund të konkludohet nga analiza dhe nga praktika gjyqësore e Gjykatës (Shih Rastin K0 97/ 12, parashtrues i kërkesës: *Avokati i Popullit,* Aktgjykimi i 12 prill it 2013).
30. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] të Kushtetutës, që parasheh:
"1. Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.
2. Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe nuk pranon udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtetin në Republikën e Kosovës".
31. Prandaj, Gjykata konkludon se, në kërkesën e tanishme K0 22/15, parashtruesi i kërkesës nuk ngre ndonjë çështje që eventualisht do të hynte në kuadër të kompetencës se tij, siç parashihet me dispozitat kushtetuese. Prandaj, me parashtrimin e kësaj kërkese, parashtruesi nuk ka ushtruar funksionet dhe kompetencat e tij kushtetuese. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës dështon të pohojë ndonjë shkelje të dispozitave specifike kushtetuese lidhur me të drejtat dhe liritë themelore te tij, ose të ndonjë individi a grupi të individëve […]".

248 Aktvendimi në rastin **KO 22/15**, paragrafët si vijon:
"[…] 49. Gjykata rikujton se pretendimi kryesor i parashtruesit të kërkesës për rishqyrtimin e Rastit K0 155/14 është mungesa e kuorumit kur është marrë Aktvendimi...
57. Gjykata specifikon se Rasti KO 155/14 është diskutuar paraprakisht më 27 tetor 2014 dhe, më 4 nëntor 2014, Kolegji shqyrtues njëzëri miratoi raportin e gjyqtarit raportues dhe Projekt aktvendimin për papranueshmëri.
58. Të njëjtën datë, Aktvendimi për papranueshmëri iu dërgua për komente në afatin dhjetëditor të gjithë gjyqtarëve në pajtim me nenin 22, paragrafët 7 dhe 8, të Ligjit. Pasi kaloi koha për kundërshtime ndaj Aktvendimit për papranueshmëri, ai u nënshkrua nga Kryetari i Gjykatës dhe nga gjyqtari raportues. Aktvendimi për papranueshmëri u publikua në Gazetën Zyrtare me 17 nëntor 2014.
59. Rrjedhimisht, procedura e ndjekur ne Rastin K0 155/14 ishte në pajtueshmëri me nenet 19 dhe 22 te Ligjit.
60. Prandaj, Gjykata thekson se vendimi i saj lidhur me Kërkesën K0 155/14 është i formës se prerë dhe i detyrueshëm për gjyqësorin, për të gjithë personat dhe për institucionet e Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 116.1 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës.
61. Gjykata rikujton se Dekreti i Presidentes së Republikës së Kosovës është kushtetues, pasi është nxjerrë në bazë të obligimeve ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, siç është definuar në marrëveshjen bilaterale. Kushtetutshmëria e përmbajtjes së kësaj marrëveshjeje nuk mund të vlerësohet nga Gjykata. (Shih Rastin KO 95/13, parashtrues: *Vîsar Ymeri dhe* 11 *deputete te tjerë te Kuvendit te Republikës* se *Kosovës,* Aktgjykimi i 9 shtatorit 2013).
62. Përmbajtja e Dekretit te Presidentes së Republikës së Kosovës është përcaktuar me marrëveshjen bilaterale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Dekreti u ratifikua me shumicën e 2/3 te Kuvendit të Republikës së Kosovës. Është obligim kushtetues i Presidentes së Republikës së Kosovës që ta barte këtë tekst, ashtu siç është, nga marrëveshja bilaterale në Dekretin e saj dhe ta ekzekutojë atë nëpërmjet Dekretit të saj.
63. Dekreti i Presidentes së Republikës së Kosovës u shpall se ishte në pajtueshmëri me Kushtetutën. Pra, çështja e kushtetutshmërisë se Dekretit të Presidentes së Republikës së Kosovës është bërë *res judicata.*
64. Në këto rrethana, Gjykata rikujton se ajo tashmë ka vendosur për Rastin KO 155/14. Ajo kishte konkluduar se Dekreti i Presidentes së Republikës së Kosovës ishte në pajtueshmëri me Kushtetutën […]."

249 Aktvendimi në rastin **KO 22/15**, paragrafi si vijon:
"[…] 9. Me 17 prill 2015, Gjykata, pa praninë e Kryetarit të Gjykatës, shqyrtoi kërkesën e parashtruesit për përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës dhe vendosi, njëzëri, ta refuzoje atë *(Shih Vendimin lidhur me kërkesën për përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 17 prillit 2015)*[…]".

për rrogën e majme si pasojë e vendosjes së rasti **KO 155/14**,[250] kishte sajuar rrejshëm tregimin mbi vetëpërjashtimin e tij nga vendosja në këtë rast. D.m.th. kishte marrë kontratën dhe rrogën, por ishte vetëpërjashtuar (sic!). Kishte thënë se ka qenë prezent por nuk ka votuar.[251] Në ditën kur është vendosur rasti në **Kolegjin Shqyrtues të Gjykatës Kushtetuese**, siç dëshmohet qartë nga data gjykimit dhe vendosjes së rastit **KO 155/14,**[252] ai jo vetëm që nuk ka qenë në Gjykatë, por as në **Evropë**: në atë kohë, ai ka qenë në **SHBA**, matanë **Atlantikut**, siç ka qenë mbi 90 për qind të kohës së tij, rrethanë kjo që e ka çuar atë në hetime ndërkombëtare për korrupsion dhe mashtrim.[253]

Tani, në rastin **KO 22/15**, gjyqtari **Robert Carolan** sërish po synonte të ndiqte rrugën e njëjtë të manipulimit të opinionit publik kosovar dhe të kolegëve të vet në Gjykatë me idetë e tij fiktive mbi vetëpërjashtimin. Këtë herë, megjithatë, Gjykata me kujdes të shtuar dhe me përpikëri zbatoi, siç kishte proceduar çdoherë me kërkesat për përjashtim, çdo dispozitë të **Ligjit Nr. 03/L-121** dhe **RP** që normojnë përjashtimin e gjyqtarëve kushtetues. Në fillim, ish-Kryetari i Gjykatës, autori i parë i librit, e detyroi atë që kërkesën e vet me shkrim ta protokollonte në librin e **Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese**. Pas kësaj, Kryetari i Gjykatës u kujdes që vetë gjyqtari në fjalë që kërkonte përjashtim, të bëjë arsyetimin e kërkesës së tij me shkrim para krejt trupës gjyqësore kushtetuese, përkatësisht para Gjykatës në përbërje të plotë. Pasi u dëgjua më datën 17 prill 2015, **Kryetari i Gjykatës** u kujdes që gjyqtari **Robert Carolan** ta lëshojë sallën menjëherë dhe të presë vendimin lidhur me kërkesën e tij për përjashtimin, gjë të cilën e pat bërë me shumë vështirësi, aq sa ishte dashur këmbëngulja unanime e gjyqtarëve për ta nxjerrë nga salla.[254]

---

[250] Cf. shtjellimet tona në seksionin 12.1, **supra**, në këtë kapitull.

[251] Aktvendimi në rastin **KO 22/15**, paragrafët që kanë të bëjnë me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, si vijon:
"[…] 20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i kontestuar për papranueshmëri K0 155/14 nuk ishte marre ne pajtim me nenin 19 [Marrja e vendimeve], paragrafi 2, të Ligjit që përcakton se *"Gjykata Kushtetuese ka kuorum nëse janë të pranishëm shtatë* (7) *gjyqtarë".*
21. Duket se parashtruesi i kërkesës filloi një hetim ex *officio* lidhur me procedurat qe çuan deri te Aktvendimi për papranueshmëri dhe, si përgjigje, gjyqtari Carolan e informoi atë si në vijim:
"Nuk kam marrë pjesë në shqyrtimin ose në vendimin e Gjykatës sepse e kisha përjashtuar veten paraprakisht nga pjesëmarrja në shqyrtimin dhe vendimin e Gjykatës lidhur me Rastin KO 155/14".
22. Sipas parashtruesit të kërkesës, *"Gjyqtari Carolan ka dërguar, gjithashtu, një kopje të një komunikimi të brendshëm të Gjykatës Kushtetuese, i cili, sipas tij, konfirmon përjashtimin e tij prej procedurës së rastit".*
23. Në këtë letër, gjyqtari Robert Carolan, po ashtu informon:
"Unë isha i pranishëm në Gjykatë kur u parashtrua dhe u diskutua Kërkesa KO 155/14 në Gjykatë". […]"

[252] Aktvendimi në rastin **KO 155/14**, paragrafi si vijon:
"[…] 11. Më 4 nëntor 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës në përbërje të plotë rekomandim për papranueshmërinë e kërkesës. […]".

[253] Cf. fusnotat nr. 30, & 80, **supra**, në këtë kapitull, si dhe fusnotën nr. 19 në **Kapitullin 11.**

[254] Aktvendimi në rastin **KO 22/15**, paragrafët si vijon:
"[…] 8. Me 2 mars 2015, gjyqtari Robert Carolan kërkoi me shkrim nga Kryetari i Gjykatës, që t'i lejohej përjashtimi *"nga pjesëmarrja në këshillime dhe në votim për këtë rast",* në pajtim me nenin 18, paragrafi 1.1, të Ligjit dhe në pajtim me nenet 1 dhe 2 të Kodit të mirësjelljes për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese.
….
10. Në të njëjtën datë, Gjykata, në respektim të dispozitave të Ligjit dhe të Rregullores së punës dhe të praktikës së saj të vendosur, shqyrtoi kërkesën e gjyqtarit Robert Carolan për përjashtimin e tij dhe vendosi, me shumicë votash, që të lejojë kërkesën e tij dhe ta përjashtojë atë nga pjesëmarrja në Kërkesën KO 22/15, pasi gjyqtari Robert Carolan mund të përballet me konflikt interesi.
11. Neni 18 (Përjashtimi i gjyqtarit), paragrafët 4 dhe 5, i Ligjit, thotë:
[...] 4. Vendimi për përjashtimin e gjyqtarit duhet të jetë i arsyetuar; 5. Gjyqtari i cili ka njohuri se plotëson të paktën njërin prej kushteve për përjashtim nga procedura, ka për detyrë ta njoftojë me shkrim Kryetarin e
Gjykatës Kushtetuese dhe të kërkojë përjashtimin e tij/saj nga procedura. Në këtë rast, paragrafët 3 dhe 4 zbatohen përshtatshmërisht".
12. Për më tepër, rregulli 7 [Procedurat e përjashtimit], paragrafët 1 dhe 6, të Rregullores së punës, thotë:
" (1) Sapo gjyqtari të mësojë ndonjë arsye për përjashtim, të paraparë me nenin 18 të Ligjit për Gjykatën, ose nëse gjyqtari beson që ekzistojnë rrethana të tjera që ngrenë dyshim të arsyeshëm përkitazi me paanësinë e
tij/ saj, ai/ ajo do të përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurë dhe do t'ia shpjegoji arsyen me shkrim Kryetarit të Gjykatës. Nga një kopje e ati shpjegimi do t'i dërgohet të gjithë gjyqtarëve". [...]
(6) Kur gjyqtari përjashtohet nga procedura, Gjykata shënon në çdo vendim me shkrim apo në çdo aktgjykim se gjyqtari i përjashtuar nuk kishte marrë pjesë në procedurë".
13. Sipas praktikës së vendosur të Gjykatës, në bazë të Ligjit dhe Rregullores së punës, kërkesa për përjashtim bëhet sapo të mësojë gjyqtari ndonjë arsye për përjashtim. Kërkesa për përjashtim të një gjyqtari nga procedura diskutohet dhe votohet pa praninë e gjyqtarit në fjalë. Nëse kërkesa lejohet, gjyqtari nuk merr pjesë në këshillimet dhe në votimin për rastin dhe emri i tij/saj nuk paraqitet në përbërjen e Gjykatës në vendimin përfundimtar (Shih Rastet Kl 88/10 parashtrues *Agim Paca,* Aktvendim për papranueshmëri, i 22 dhjetorit 2010; KI 70/11 parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima, Bestar Hima,* Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011; dhe KI 79/12 parashtrues *Tanasko Djordjevic dhe të tjerët,* Aktvendim për papranueshmëri, i 2 dhjetorit 2013) [...]"

Në momentin e përjashtimit të gjyqtarit **Robert Carolan** në rastin **KO 122/15**, Gjykata humbi kuorumin, si pasojë e faktit që gjyqtari **Kadri Kryeziu** ende ishte me ndalesë për të marrë pjesë në gjykime.[255] Për këtë arsye, Kryetari i Gjykatës me një urdhër të veçantë pezulloi vendimmarrjen për rastin e kërkesës së dytë të **Avokatit të Popullit** deri në zgjedhjen e gjyqtarit të ri. Kjo ndodhi pas ardhjes së **Bekim Sejdiut** gjyqtar i Gjykatës kushtetuese.[256] Po atë ditë u vendos që gjyqtari **Kadri Kryeziu** të rikthehej në trupën gjykuese, pas një vlerësimi që Gjykata i kishte bërë kërkesës së tij për mëshirë.[257] Me këtë u krijua kuorumi i Gjykatës Kushtetuese dhe u vendos për rastin e kërkesës së dytë të **Avokatit të Popullit**, përkatësisht për kërkesën **KO 122/15**.

Ky profesionalizëm i Gjykatës e kishte bërë gjyqtarin **Robert Carolan** të zhgënjehej në pritjet e tij për të përligjësuar situatën tërësisht fiktive të krijuar nga vetë ai se gjoja e paskësh pas përjashtuar vetveten nga rasti i parë i kërkesës së **Avokatit të Popullit**, rasti **KO 155/14**. Kjo bëri që ai të nisë fushatën klandestine me **Avokatin e Popullit**, nën petkun e të a.q. hetime të pavarura për gjoja falsifikim të nënshkrimit të gjyqtarit **Robert Carolan** në rastin **KO 155/14**. Për këtë, Gjykata ishte mbledhur në përbërje të plotë dhe ishte dakorduar që asnjë përgjigje mos t'i jepej **Avokatit të Popullit** në kërkesat e tij absurde, sepse një gjë e tillë përbënte shkelje kushtetuese e ligjore. Kur çështja kaloi për hetim në **Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës**, fillimisht si si një **parahetim**, atëherë Gjykata mori qëndrim të ri: me një shkresë të datës 15 mars 2015 informoi prokurorin e rastit se vendimi në rastin **KO 155/14** ishte marrë në tërësi duke respektuar Kushtetutën, **Ligjin Nr. 03/L-121** dhe **RP** lidhur me përjashtimin e gjyqtarit kushtetues, si dhe me çdo standard tjetër të vendimmarrjes, siç kishte vendosur në të gjitha rastet tjera që nga fillimi i punës së saj.[258] Kur Gjykata shpresoi se kjo punë tanimë ishte sqaruar dhe se ky lloj huliganizmi institucional po merrte fund, pikërisht atëherë nisi procedura e mirëfilltë e hetimeve nga organi i akuzës me qëllim të sigurimit të provës përmes **Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda** (**GJTHDKR**).[259] Si provë paraqitej dëshmia e dëshmitarit **Robert Carolan**, njeriut me **imunitet diplomatik**, i cili imunitet ka një natyrë absolute ndaj çdo procedure ligjore, përfshirë këtu edhe imunitetin nga dhënia e dëshmisë së rreme të cilën po përgatitej për ta dhënë në gjykatën kompetente – **GJTHDKR**.

Ish-Kryetari i Gjykatës përmes avokatit të vet dhe gjyqtarja **Arta Arma** personalisht, si gjyqtare raportuese në rastin **KO 155/14**, u lajmëruan sipas ftesës në **GJTHDKR**, duke u thirrur në **imunitet kushtetues funksional** (për vetveten dhe gjyqtarin kushtetues **Robert Carolan**, për të cilin po ashtu vlente **imuniteti funksional**) dhe në **imunitet diplomatik** (të gjyqtarit ndërkombëtar **Robert Carolan**), si dy pengesa absolute për nisjen e çfarëdo procedure ligjore kundër tyre për shkak se rasti në fjalë vërtetë ishte vendosur në kuadër të juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese nga neni 113.2 (1) i Kushtetutës. Në të njëjtën kohë, **ish-Kryetari i Gjykatës** kishte dërguar, në të njëjtën kohë, një shkresë në **EU-**

---

255 Cf. fusnotat nr. 125-129, 134, **supra**, në këtë kapitull me komentet tona aty.

256 Cf. **Bekim Sejdiu** ka dhënë betimin më datën 15 prill 2015. Cf. fusnota nr. 83, **supra**, në këtë kapitull, si dhe komentet tona aty.

257 Cf. fusnotat nr. 125-129, 134, **supra**, në këtë kapitull me komentet tona aty. Në këtë kontekst ka rëndësi që lexuesi të shoh paragrafët si në vijim të **Vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. ref. 789/15 për rivendosjen e gjyqtarit Kadri Kryeziu** të datës 17 prill 2015:
"[…] 1. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), rikujton se ajo, me 19 gusht 2014, shqyrtoi dhe miratoi Aktvendimin KK 124/ 14.
2. Më 17 prill 2015, gjyqtari Kadri Kryeziu i dorëzoi kërkesën Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kryetari i Gjykatës) që të rivendoset për të marrë pjesë në shqyrtimin e të gjitha kërkesave në Gjykate.
3. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës ia paraqiti Gjykatës kërkesën e gjyqtarit Kadri Kryeziu.
4. Gjykata shqyrtoi dhe votoi, njëzëri, që ta miratojë kërkesën e gjyqtarit Kadri Kryeziu për të marrë pjesë në shqyrtime për të gjitha kërkesat në Gjykatë."

258 Cf. **Letër e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës**, Nr. ref.: 63/151 e datës 16 mars 2015, drejtuar **Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës**. Këtë rrethanë, në fakt, e kishte konstatuar Gjykata edhe në Aktvendimin në rastin **KO 122/15**, në paragrafët si vijon:
"[…] 57. Gjykata specifikon se Rasti KO 155/14 është diskutuar paraprakisht me 27 tetor 2014 dhe, më 4 nëntor 2014, Kolegji shqyrtues njëzëri miratoi raportin e gjyqtarit raportues dhe Projektaktvendimin për papranueshmëri.
58. Të njëjtën datë, Aktvendimi për papranueshmëri iu dërgua për komente në afatin dhjetëditor të gjithë gjyqtarëve në pajtim me nenin 22, paragrafët 7 dhe 8, të Ligjit. Pasi kaloi koha për kundërshtime ndaj Aktvendimit për papranueshmëri, ai u nënshkrua nga Kryetari i Gjykatës dhe nga gjyqtari raportues. Aktvendimi për papranueshmëri u publikua në Gazetën Zyrtare më 17 nëntor 2014.
59. Rrjedhimisht, procedura e ndjekur ne Rastin KO 155/14 ishte në pajtueshmëri me nenet 19 dhe 22 të Ligjit.
60. Prandaj, Gjykata thekson se vendimi i saj lidhur me Kërkesën KO 155/14 është i
formës se prerë dhe i detyrueshëm për gjyqësorin, për të gjithë personat dhe për institucionet e Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 116.1 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës. […]"

259 Cf. **Republika e Kosovës/Gjykata Themelore në Prishtinë/ Departamenti i Krimeve te Rënda/FTESË.** PPRKR nr.130115 / Më dt. 07.05.2015.

LEX me të cilën sqaronte se punëtori i këtij misioni, gjyqtari **Robert Carolan**, po abuzonte me **imunitetin diplomatik** duke dhënë dëshmi të rreme.[260] Përgjigja e **EULEX** ishte siç pritej, profesionale dhe me kompetencë. Në te theksohej se misioni **EULEX** do ta shqyrtonte me seriozitet çdo kërkesë për heqje të **imunitetit diplomatik** të gjyqtarit **Robert Carolan** nëse do të kërkohej nga organi i akuzës.[261] Sikur mos të ekzistonte asnjë jurist normal në **GJTHDKR**, tërë dosja rreth imunitetit të ish-**Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese**, autori i parë i këtij libri, dhe gjyqtares raportuese në rastin **KO 155/14**, **Arta Rama-Hajrizi**, u dërgua në **Kuvendin e Kosovës** nga i cili kërkohej dhënia e mendimit lidhur me imunitetin funksional të gjyqtarëve të **GJKRKS**. Kjo e rikthente kohën e komunizmit në Kosovë, kohë kur për **imunitetin e gjyqtarëve kushtetues** ka vendosur **Kuvendi i Kosovës**. Dihet mirëfilli, nëse veç duhej dërguar, kërkesa do të duhej të bëhej nga organi i akuzës, asnjëherë nga **GJTHDKR**, e cila për turpin e saj e kishte dërguar dosjen në **Kuvendin e Kosovës** me kërkesë për të sqaruar çështjen e imunitetit si më sipër.[262] Me këtë veprim, **GJTHDKR** po merrte detyrën e organit të akuzës. Kjo përbën një shkelje të rëndë kushtetuese e ligjore të rregullës mbi ndarjen e pushteteve. Kjo situatë ngjasonte me skenarin e **Franc Kafkës** te **Procesi.**[263]

Organi që sqaron dhe vendos lidhur me **imunitetin funksional** është vetë dhënësi i tij, **Presidenti i Republikës**. E njëjta gjë ka vlejtur edhe për **imunitetin diplomatik** të dëshmitarit të rrejshëm, gjyqtarit kushtetues **Robert Carolan**: imuniteti i tij diplomatik mund të hiqej vetëm nga dhënësi i tij, misioni **EULEX**, përkatësisht **Sekretari i Përgjithshëm i OKB**-së. Kjo sepse **EULEX** ka punuar si një mision regjional nën mandatin e **Rezolutës 1244.**[264] Në rastin e imunite-

---

260 Letra e autorit të parë të këtij libri e datës 18 dhjetor 2015, drejtuar shefit të prokurorëve të misionit EULEX të kohës, italianit zt. **Claudio Pala**.

261 Përgjigja e zyrës së shefit të kabinetit të misionit **EULEX** e datës 15 janar 2016, Referencë: 2015-COS – 1193.

262 Cf. Letra PPRKR Nr. 130/15 e datës 20.05.2015 e **GJTHDKR** në **Prishtinë.**

263 Në romanin PROCESI, i botuar në vitin 1925 post-mortem, Franc Kafka tregon dramën njerëzore në ngjarjen e një njeriu të arrestuar, akuzuar dhe dënuar nga një autoritet i largët dhe i paqasshëm, ku natyra e krimit nuk bëhet e ditur as për të akuzuarin/dënuarin e as për vetë lexuesin. Cf. më shumë në *Franz Kafka, Vepra e plotë në prozën e shkurtër* nga Ardian Klosi (Dudaj: Tiranë, 2016).

264 Cf. paragrafet e letrës së autorit të parë të këtij libri, drejtuar **GJTHDKR** në **Prishtinë** më datën 16 dhjetor 2015 (e njëjta letër iu është dorëzuar përmes avokatit edhe **EULEX**-it, i cili ka kthyer përgjigjen e sipërpërmendur në fusnotën nr. 260, **supra**, në këtë seksion), si vijon:
"[...]
50. Përveç **KVMD** sa më sipër, shtojmë se ekziston dhe aplikohet në Kosovë ndaj ndërkombëtarëve në Gjykatën Kushtetuese dhe gjetiu edhe Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Imunitetet dhe Privilegjet e datës 13 shkurt 1946, miratuar nga **Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara**. Kjo konventë është e aplikueshme në Kosovës përmes **Rezolutës 1244** të **Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara** të datës 10 qershor 1999, si dhe 1 pikës 2.3 [Qëllimi] të **Ligjit Nr. 05/L-102 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Sundimit të Ligjit në Kosovë** të datës 17 qershor 2016 me të cilin i jepet fuqi e plotë juridike Ligjit Nr. 03/L-033 për Statusin, Imunitetet dhe Privilegjet e Misioneve Diplomatike dhe Konsullore dhe Personelin e Kosovës dhe Praninë Ndërkombëtare Ushtarake si dhe Personelin e Saj të datës 20 shkurt 2008.
51. Dispozitat relevante më këtë rast përcaktojnë si vijon:
"*[...]*
Seksioni 14. *Privilegjet dhe imunitetet iu janë dhënë përfaqësuesve të anëtarëve jo për përfitime personale vetanake por me qëllim të sigurimit të pavarësisë së tyre në ushtrimin e funksioneve të tyre lidhur me Kombet e Bashkuara. Për pasojë, anëtari jo vetëm që ka të drejtë por edhe detyrë që ta heq imunitetin e përfaqësuesit të vet në çdo rast kur në opinionin e anëtarit imuniteti mund të shërbej si pengesë për dhënien e drejtësisë, dhe si i tillë mund të hiqet pa paragjykuar qëllimin për të cilin imuniteti është dhënë.*
Seksioni 18. *Zyrtarët e Kombeve të Bashkuara duhet:*
(a) të jenë imun nga procesi legal për fjalët e thëna apo të shkruara dhe veprimet e ndërmarra nga ata në cilësi zyrtare;
[...]
Seksioni 20. *Privilegjet dhe imunitetet janë dhënë për zyrtarët në interes të kombeve të Bashkuara dhe jo për përfitim personal të vetë individëve/ Sekretari i Përgjithshëm do të ketë të drejtën dhe detyrimin e heqjes së imunitetit të çdo zyrtari në rastet kur, sipas opinionit të tij, imuniteti pengon dhënien e drejtësisë dhe si i tillë mund të hiqet pa paragjykuar interesat e Kombeve të Bashkuara.*
[...]"
52. Siç u theksua më lartë, **Konventa mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Kombeve të Bashkuara** po ashtu është e aplikueshme në tërësi ndaj gjyqtarëve ndërkombëtarë, si dhe ndërkombëtarëve tjerë, që punojnë në Gjykatën Kushtetuese. Kjo sepse ata janë në kapacitet kontraktues si gjyqtarë të **EULEX**-it kurse vetë **EULEX**-i dihet mirëfilli se vishet me mandat nga **Organizata e Kombeve të Bashkuara** sipas **Rezolutës 1244** të Këshillit të Sigurimit të **Organizatës së Kombeve të Bashkuara**. Si i tillë, imuniteti i ndërkombëtarëve të punësuar në Gjykatën Kushtetuese mund të hiqet vetëm nga Organizata e Kombeve të Bashkuara para se të zhvillohet çfarëdo procesi juridik në të cilin ata duhet të marrin pjesë në çfarëdo cilësie qoftë.
53. Për më tepër, në vijim sa më sipër, sipas njohurisë sime krejt të të sigurt, gjyqtari **Robert Carolan** në cilësinë e tij kontraktuese me **EULEX**-in **nuk ka marrë leje dhe nuk konsultuar asnjëherë** Misionin e **EULEX**-it ashtu siç parashikohet sipas dispozitave të **EULEX**-it për sjelljen dhe imunitetin e secilit anëtarë të stafit të **EULEX**.
54. Kjo donë të thotë se gjyqtari **Robert Carolan** asnjëherë nuk ka marrë lejen dhe autorizimin shprehimor dhe konkret për t'iu përgjigjur ish **Avokatit të Popullit**, zt. **Sami Kurteshi**, sipas kërkesës së këtij të fundit të shprehur në letrën drejtuar të gjithë gjyqtarëve ndërkombëtar më datën 16 janar 2015. Po ashtu, gjyqtari Rober Carolan nuk ka pasur leje dhe autorizim shprehimor dhe konkret për të bashkëpunuar më

tit funksional, heqja e tij mund të bëhet vetëm me propozim të Gjykatës Kushtetuese. Kjo është standard që zbatohet në të gjitha gjykatat kushtetuese të **modelit kelsenian/evropaian**, pa marrë parasysh nëse kushtetutat nacionale garantojnë **imunitet funksional** apo **imunitet të përgjithshëm**. Heqja e imunitetit nga dhënësi i tij, në vartësi të asaj se kush i cakton gjyqtarët kushtetues, paraqet njërin prej standardeve të kamotshme: kjo zakonisht bëhet sipas propozimit paraprak të vetë gjykatës kushtetuese, përkatësisht gjykatës tjetër e barasvlefshme me një gjykatë kushtetuese.[265] Në një ekstrem tjetër, ka shtete që në kushtetutat e tyre fare nuk kanë dispozita për imunitetin e gjyqtarëve kushtetues apo gjyqtarëve të barasvlefshëm më gjyqtarët kushtetues.[266]

U mor vesh, në të gjitha rastet kjo supozon ekzistimin e një kërkese të vlefshme nga organi i akuzës për sqarim apo heqje të imunitetit (si atij funksional ashtu dhe të atij diplomatik). Kjo assesi nuk mund të iniciohet nga gjykatat, të cilat duhet të gjykojnë rastin konkret. Thënë me fjalë të tjera, heqja e imunitetit funksional dhe diplomatik mund të ndodhë vetëm nëse kërkohet nga organi i akuzës dhe propozohet nga dhënësi i tij. Në rastin e atij funksional, si propozues paraqitet çdoherë gjykata kushtetuese respektive, kurse në atë të imunitetit diplomatik, si propozues paraqitet kontraktuesi i palës, në rastin tonë misioni **EULEX**. Ai mund të ketë qenë edhe ndonjë mision tjetër i mandatuar nga organi përkatës ndërkombëtar, siç është **OKB, BE, OSBE, NATO** apo organizatat tjera të ngjashme me to. Heqjen e këtij të fundit, imunitetit diplomatik, ndërkaq, e bën eprori më i lartë i organizatës ndërkombëtare. Në rastin e imunitetit diplomatik në nivel bilateral (në mes të shteteve), pra në misionet diplomatike dypalëshe (por edhe shumëpalëshe), një gjë të tillë e bënë shefi i shtetit dërgues përmes kanaleve diplomatike. Gjithnjë me supozim se ka një kërkesë nga organi i akuzës së shtetit përkatës, asnjëherë me vetiniciativë apo me kërkesë të gjykatës vendore.

Fakti se këto sqarime si më sipër nuk janë të shkruara në mënyrë shprehimore në Kushtetutën nuk ndryshon asgjë sepse dispozitat për shkarkim nga detyra të gjyqtarëve kushtetues janë të qarta dhe i referohen një situate afërsisht të njëjtë me çështjen e imunitetit funksional. Pikërisht dispozitat që flasin për shkarkimin duhet të zbatohen, **mutatis mutandis**, për sqarimin dhe heqjen e imunitetit në çdo rast kur një gjyqtar kushtetues mendohet se ka rënë ndesh me ligjin. Kjo, megjithatë, mund të bëhet dhe duhet të bëhet vetëm me kërkesën e organit të akuzës, asnjëherë me kërkesë të **GJTHDKR** drejtuar Kuvendit të Kosovës. Kjo sepse, një kërkesë e tillë përbën cenim të hapur të normave kushtetuese e ligjore mbi ndarjen e pushteteve. Thënë me fjalë tjera, një kërkesë e tillë përbën ushtrim pa të drejtë të kompetencave të organit të akuzës nga ana e **GJTHDKR** dhe nga vetë **Kuvendi i Kosovës**. Ky i fundit,

---

organet tjera të hetuesisë kosovare, përfshirë këtu dhënien e dëshmisë në Prokurori.

55. Mbi të gjitha, gjyqtari **Robert Carolan** nuk ka pasur asnjëherë leje për të dhënë dëshmi e cila më pastaj ka shërbyer si bazë për ngritjen në mënyrë krejt kundërkushtetuese e kundërligjor të aktakuzës kundër klientit tim prof. dr. **Enver Hasani**, Aktakuza PPS Nr. 18/2015 e datës 13 janar 2016.

56. Gjyqtarit **Robert Carolan** as nuk ka guxuar ti dërgohet ftesa për shkak të imunitetit diplomatik dhe funksional, lërë me të merret në pyetje në cilësinë e "dëshmitarit". Kjo është në tërësi kundër dispozitave kushtetuese mbi imunitetin funksional, dhe atyre ligjore e ndërkombëtare, kur është fjala për imunitetin diplomatik.

57. Përveç konventave ndërkombëtare, imuniteti diplomatik paraqet një normë ***jus cogens*** të së drejtës ndërkombëtare zakonore ashtu që edhe sikur mos të ekzistonin konventat ndërkombëtare të sipërcituara, imuniteti diplomatik do të vlente si tërësi për territorin e Kosovës. **Nuk është shënuar asnjë rast në praktikën e shteteve në dy anët e Atlantikut që një person me imunitet diplomatik të ketë dhënë dëshmi për çfarëdo qoftë pa pasur lejen e organit apo shtetit që e ka veshur me imunitet diplomatik. Kjo është rasti i parë që do të mbahet mend që një person i veshur me imunitet diplomatik jep dëshmi për një çështje penale pa u hequr imuniteti i tij diplomatik. [...]".**

265 Imuniteti gjyqësor normalisht mund të hiqet nga vetë gjykata (**Bullgaria, Kroacia, Gjorgjia, Hungaria, Italia, Lituani, Maqedonia, Polonia, Portugalia, Rusia, Sllovakia, Turqia dhe Zvicra**) dhe disa herë vetëm sipas kërkesës së prokurorit të përgjithshëm (**Bullgaria, Lituania**). Autoritetet tjera që kanë autorizim për të revokuar imunitetin e gjyqtarit janë ato autoritete që kanë vendosur gjyqtarin: ai autoritet është asambleja nacionale apo presidenti i republikës. Edhe këtu, megjithatë, revokimi ndodhë vetëm sipas propozimit të vetë gjyqtarëve kushtetues (**Armenia)**, Këshillit Gjyqësor (**Kanada**), Kancelarit të Drejtësisë (një lloj avokati i popullit) pas pëlqimit paraprak të shumicës parlamentare (**Estonia**), Dhomës së Përfaqësuesve (**Argjentina, Ukraina**), Dhomës ë Lartë të Parlamentit (**Republika e Çekisë**), Parlamentit (**Latvia, Sllovenia**), Presidentit të Zyrës Permanente të Dhomës së Ultë apo Senatit, në vartësi se cili autoritet fillimisht ka caktuar gjyqtarët kushtetues, mirëpo gjithnjë sipas kërkesës së Prokurorit të Përgjithshëm (**Rumania**), me një akt të Parlamentit apo me pëlqim të Presidentit të Republikës (Azerbajxhani). Cf. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *The Composition of Constitutional Courts,* fq.17 & Aneksi III ["Comparative Table of Replies to the Questionnaire on the Composition"] Table C., fq. 82-103.

266 Në disa juridiskione nuk ekzistojnë dispozita të veçanta për imunitetin gjyqësor (**Austria, Finlanda, Franca, Islanda, Japonia, Lihteshtajni, Malta, Norvegjia, Suedia**).

për hir të së vërtetës, më datën 29 korrik 2015 ka treguar se nuk ka asnjë kompetencë për të vendosur për imunitetin e gjyqtarëve kushtetues.[267]Kjo përgjigje, megjithatë, u shfaq me nëntë muaj vonesë: nuk shkoi shumë ditë dhe u ngrit aktakuza formale kundër autorit të parë të këtij libri, kurse akuzat ndaj gjyqtares raportuese u tërhoqën, pa çka se asnjë provë apo rrethanë e re nuk kishte lindur apo nuk ishte zbuluar pos atyre fiktive të sajuara nga gjyqtari **Robert Carolan.**[268]Asnjë fakt apo provë e re nuk fliste as për pushim e as për akuzë ndaj askujt. Të gjitha shkallët e gjyqësorit kosovar, megjithatë, u detyruan të veprojnë sipas aktakuzës tanimë të ngritur, deri në nivelin e Gjykatës Supreme. Të gjitha shkallët vendosën ashtu siç pritej logjikisht: u konstatua se jo vetëm që nuk ka qenë dashur të fillojë asnjë hetim dhe aktakuzë për shkak të ekzistimit të pengesave ligjore të imunitetit funksional të të akuzuarit, autorit të parë të këtij libri, dhe imunitetit diplomatik të dëshmitarit të rrejshëm, ish-gjyqtarit kushtetues **Robert Carolan**, por as që është bërë fjalë ndonjëherë për kryerjen e ndonjë vepre penale nga ana e ish-kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.

Gjykatat e Kosovës thanë se, në rastin **KO 155/14**, çdo gjë ishte shqyrtuar dhe vendosur sipas rregullave të profesionit, të zbatueshme për gjyqësinë kushtetuese në **Kosovë** dhe në krejt modelet **kelseniane/evropiane** të gjyqësisë kushtetuese, siç kishte qenë rasti me çdo vendim që nga themelimi i Gjykatës Kushtetuese në vitin 2009. Më datën 20 prill 2017, autori i parë i këtij libri, sërish i ka dërguar **EULEX**-it një letër tjetër me të cilin e njofton për këtë paturpësi të ish-punëtorit të vet, gjyqtarit **Robert Carolan**, duke kërkuar nga ky organ ndërkombëtar sqarime shtesë për sjelljet tërësisht joprofesionale të këtij gjyqtari. Në përgjigjen e vet, **EULEX**-i theksonte se, me shumë keqardhje, i kanë përcjellë sjelljet e këtij gjyqtari, duke sqaruar se i njëjti person më nuk gëzonte mbrojtjen e misionit në fjalë sepse tanimë ishte përzënë nga ky mision.[269] Më herët kemi sqaruar se në momentin që misioni **EULEX** ia ka bërë me dije ish-gjyqtarit **Robert Carolan** se ata do t'ia heqin **imunitetin dipolomatik** për t'u ballafaquar si palë e barabartë në **GJTHDKR** me autorin e parë të këtij libri, ai kishte dhënë dorëheqje dhe si një dëshmitar i rrejshëm e ka lënë Kosovën për të mos u parë më kurrë në te që atëherë.[270] Në ndërkohë, autori i parë i këtij libri ka ngritur padi civile kundër **Shtetit të Kosovës** për zhdëmtim për dëmin e shkaktuar, material dhe moral, dhe është në përgatitje të një kallximi penal për të gjithë ata që kanë qenë të involvuar në këtë rast makabër dhe skandaloz.[271]

Përveç imunitetit, një çështje me rëndësi përbën edhe ajo lidhur me shkarkimin e gjyqtarëve kushtetues. Rregullimi i duhur i shkaqeve për shkarkim, si dhe i procedurave të shkarkimit përbën një komponentë shumë të rëndësishme të sundimit të ligjit. Kjo nga shkak se shkarkimi mund të keqpërdoret për penalizim të gjyqtarëve dhe kompromet të pavarësisë së punës së tyre. Kjo në veçanti vlen për vendet ish-komuniste, ku hyn edhe **Kosova**, për shkak të presionit të madh politik që ushtrohet mbi gjyqësorin kushtetues me rastin e vendimmarrjeve për çështjet e ndjeshme politike që kanë efekt sistemik.[272]

Në **Kosovë**, sikundër do të shihet në vijim, shkaqet dhe procedurat për shkarkim janë të qarta, të prekshme dhe transparente. Në një masë të madhe reflektojnë standardet më të larta evropiane të mishëruara në pikëpamjet e **Komisionit të Venecias**. Jo vetëm kaq! Ato reflektojnë edhe standardet ndërkombëtare që normojnë shkarkimin e gjyqtarëve në përgjithësi. Një mangësi në këtë drejtim ekziston sa i përket **Kryetarit dhe Zëvendës Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese**: Kushtetuta[273] dhe **Ligji**

---

267 Letra e **Kuvendit të Republikës së Kosovës** e datës 29 korrik 2015, gjendet në dosjen e lëndës në **GJTHDKR** në Prishtinë.

268 **Aktakuzë**. PPS nr. 18/2015. Datë: 13 janar 2016.

269 Letra e Shefes së Misionit **EULEX,** znj. **Alexandra Papadapoulou**, e datës 4 maj 2017,Reference:2017-COS- 0294

270 Cf. fusnotat nr. 28 & 80, **supra,** në këtë kapitull, si dhe komentet tona aty.

271 **GJTH në Prishtinë – DP – Divizioni Civil. PADI** C. Nr. 1652/16 për kompensim të dëmit.

272 Në **Ukrainë**, në vitin 2007, disa gjyqtarë të **GJKUk** janë detyruar të japin dorëheqje. Në vendet tjera ish-komuniste në vitet e para formative të gjykatave kushtetuese, presioni politik mbi gjyqtarët kushtetues ka qenë një standard i pashkruar. Cf. lidhur me rastin e **Ukrainës** dhe vendet tjera ish-komuniste, në analizën e shkëlqyer të Renata Uitz, "Constitutional Courts in Central and Eastern Europe: What Makes a Question Too Political?" *Juridica International* Vol. 13 No. 47 (2007) fq.47-59.

273 Neni 118 ["Shkarkimi"] i Kushtetutës:
"Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese mund të shkarkohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës me propozimin e dy të tretave (2/3) të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, vetëm për kryerjen e krimeve të rënda ose për mospërfillje të rëndë të detyrave."

Nr. 03/L-121[274] janë të heshtur sa i përket shkaqeve dhe procedurave të shkarkimit të tyre. **RP**, ndërkaq, përmbajnë dispozita mjaft të detajuara në këtë drejtim, si lidhur me shkaqet për shkarkim ashtu edhe sa i përket procedurës që duhet ndjekur për shkarkimin e secilit, përfshirë këtu Kryetarin dhe Zëvendës Kryetarin e Gjykatës.[275] Kjo do të thotë që, nëse analizohen me kujdes dispozitat e rregullës nr. 6 të **RP** që flasin mbi shkarkimin, atëherë mund të arrihet deri te përfundimi i duhur se realisht nuk ekziston asnjë zbrazëti juridike rreth kësaj teme. Këto dispozita, megjithatë, kanë natyrë të brendshme dhe fuqi të mangët juridike. E vetmja mënyrë për fuqizimin e tyre është nëse këto rregulla të brendshme interpretohen sipas standardeve ndërkombëtare mbi shkarkimin e eprorëve të gjykatave kushtetuese dhe gjykatave të tjera të barasvlefshme me to. Në parim shkarkimi i tyre duhet të bëhet me një propozim që vjen nga vetë gjyqtarët kushtetues sipas kushteve dhe procedurave paraprakisht qartë të përcaktuara me kushtetutë dhe akte të tjera më të ulëta se ajo.

Kjo nënkupton dy gjëra: e para, se shkaqet për shkarkim të eprorëve të një gjykate kushtetuese duhet të jenë të njëjtë me shkaqet që vlejnë për secilin gjyqtarë kushtetues; e dyta, që në procesin e shkarkimit të ketë sa më shumë rol vetë trupa gjyqësore, duke larguar çdo organ politik të jashtëm nga vendimmarrja kryesore në këtë proces.[276] Kjo qasje ka nevojë për promovim me qëllim që rregullat e brendshme si më sipër të fitojnë një autorësi dhe legjitimitet sa më të madh në sytë e publikut kosovar dhe në mesin e komunitetit të gjerë juridik. Kjo duhet të jetë kështu sepse bëhet fjalë për vënien në jetë të rregullave për shkarkim të personave që udhëheqin institucionin e gjyqësisë kushtetuese kosovare. E njëjta, në fakt, duhet të vlejë edhe për shkarkimin e gjyqtarëve kushtetues sepse gëzojnë një rang shumë të lartë në hierarkinë shtetërore. T'i kthehemi sërish shkarkimit të gjyqtarëve kushtetuese në kontekstin e kuadrit kushtetues dhe ligjor të Kosovës.

Neni 118 i Kushtetutës përcakton dy kushte themelore lidhur me procedurën dhe rrethanat se kur mund të ndodh shkarkimi i gjyqtarëve kushtetues. Kushti i parë themelor është se shkarkimi mund të iniciohet dhe kryhet vetëm nga Gjykata Kushtetuese: organet e jashtme nuk kanë çfarë kërkojnë në këtë mes. Presidenti i Republikës nuk mund të mos miratojë zgjidhjen e kryer nga vetë Gjykata me anën e voti-

---

274 Neni 9.1.5 ["Përfundimi i mandatit para kohës"] i **Ligjit Nr. 03/L-121:**
"1. Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese i pushon mandati para skadimit të kohës së rregullt për të cilën është zgjedhur në rast të: … 1.5. shkarkimit sipas nenit 118 të Kushtetutës […]"

275 Rregulli 6 ["Procedurat për shkarkim"] i **RP** (miratuar më 23 nëntor 2010):
"(**1**) Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të shkarkohet vetëm në këto raste:
(**a**) në rast të kryerjes së ndonjë krimi të rëndë,
(**b**) në rast të mospërfilljes së rëndë të detyrave të punës,
(**c**) në rast të humbjes së përhershme të aftësisë për të vepruar, ose
(**d**) në rast të sëmundjes a të ndonjë problemi tjetër shëndetësor, që e bën të pamundur ushtrimin e përgjegjësive dhe të funksionit të gjyqtarit.
(**2**) Shkarkimi mund të propozohet nëpërmjet një dokumenti të shkruar, ku përshkruhet baza për shkarkim, dhe i cili nënshkruhet nga një ose më shumë gjyqtarë dhe i dorëzohet Kryetarit. Dokumentet që përmbajnë çfarëdo fakti të rëndësishëm, duhet t'i bashkëngjiten propozimit për shkarkim. Propozimi për shkarkim duhet të jetë konfidencial dhe të gjithë gjyqtarët duhet të njoftohen me të sa më shpejt që të jetë e mundur.
(**3**) Kryetari njofton me shkrim gjyqtarin e propozuar për shkarkim mbi bazën e propozimit për shkarkim dhe i jep gjyqtarit përkatës propozimin e shkruar dhe të gjitha faktet relevante të bashkëngjitura. Në rast se Kryetari propozohet për shkarkim, Zëvendëskryetari i bën njoftimin e njëjtë Kryetarit.
(**4**) Gjyqtarët mbajnë takim konfidencial, për të diskutuar shkarkimin e propozuar. Gjyqtari i propozuar për shkarkim ka të drejtë të jetë i pranishëm në takimin konfidencial dhe ka të drejtë të përgjigjet ndaj propozimit për shkarkim, të japë ose të paraqesë shpjegime ose informacione dhe t'u përgjigjet pyetjeve të gjyqtarëve.
(**5**) Gjyqtarët mbajnë një takim tjetër konfidencial nga i cili përjashtohet gjyqtari i propozuar për shkarkim. Në këtë takim, gjyqtarët përcaktojnë nëse do t'ia propozojnë këtë shkarkim Presidentit të Republikës së Kosovës. Kryetari i Gjykatës e kryeson këtë takim dhe diskutimet e gjyqtarëve mbesin konfidenciale. Për t'i propozuar shkarkimin Presidentit të Republikës së Kosovës, propozimi për shkarkim duhet të votohet nga 2/3 e të gjithë gjyqtarëve të mbetur të Gjykatës. Gjyqtarët duhet të kenë të drejtë, po ashtu nëpërmjet shumicës prej 2/3, të vendosin sanksione ose masa disiplinore që janë më pak të ashpra sesa shkarkimi, në rast se rrethanat e lejojnë një gjë të tillë."

276 Cf. European Commission for Democracy through Law (Venice Commission), *The Composition of Constitutional Courts*, paragrafi 3.2; European Commission for Democracy through Law (Venice Commission), *The Compilation of Commission Opinions, Reports and Studies on Constitutional Justice (Updated),* paragrafet: 4.5-4.7.

mit prej dy te tretave (2/3) të trupës gjyqësore. Me këtë qasje kushtetuese, **Kosova** ofron dhe garanton një autonomi të madhe që ka për qëllim ruajtjen e pavarësisë dhe integritetit të gjyqtarëve kushtetues kosovar.[277] Kushti i dytë ka të bëjë me shkaqet për të cilat mund të kërkohet shkarkimi, të cilat më tutje operacionalizohen me rregullën nr. 6 si më sipër të **RP.**[278] Në këtë kuptim, **Kosova** modelohet në vija të përgjithshme sipas sistemit gjerman: përveç që duhet vota e dy të tretave (2/3) të trupës gjyqësore, kërkohet që si shkak të jetë një pandershmëri e rëndë dhe serioze e kryer nga ana e gjyqtarit kushtetues. Në **Gjermani**, kjo kërkohet të jetë një vepër penale deri në gjashtë muaj. Në **Kosovë** nuk ka rëndësi kohëzgjatja e dënimit: për t'u shkarkuar, ajo/ai duhet të ketë kryer një krim të rëndë, apo mospërfillje të rëndë të detyrave të punës.[279]

Në disa juridiksione të tjera, autoriteti që shkarkon gjyqtarët kushtetues përcaktohet në bazë të shkaqeve për shkarkim. Në **Rusi**, ta zëmë, Gjykata Kushtetuese Federale ka kompetencë për shkarkim në rastet e rënies së kritereve për të qenë gjyqtarë kushtetues, dënimit penal, dështimit për të plotësuar detyrat apo për shkak të paaftësisë, kurse **Këshilli Federal**, me propozimin e dy të tretave (2/3) të gjyqtarëve kushtetues, mbetet përgjegjës për shkarkim në rastet e shkeljes së procedurave të caktimit të gjyqtarëve apo kur gjyqtari kushtetues ka kryer një akt të pandershëm. Në një vend tjetër, në **Ukrainë**, ekziston një zgjidhje ende më interesante: Gjykata Kushtetuese e këtij vendi ka kompetencë për shkarkim për të gjitha rastet përveç kur bëhet fjalë për konfliktin e interesit apo kur ka të bëjë me betimin gjyqësor. Në këto raste, kompetent është **Parlamenti i Ukrainës** (**Vrhovna Rada**).[280] Në fund, vlen të theksohet se ka vende ku fare nuk ekzistojnë procedurat për shkarkim të gjyqtarëve të lartë, por vetëm sa i përket gjyqtarëve të gjykatave të ulëta. I tillë është rasti me **Zvicrën.**[281]

Sipas nenit 118 si më sipër, gjyqtarët kushtetues mund të shkarkohen nga Presidenti i Republikës me propozimin e dy të tretave (2/3) të gjyqtarëve kushtetues. Shikuar në kuptim të procedurës, kjo dispozitë kushtetuese i mbron gjyqtarët nga shkarkimi nga një institucion i jashtëm, duke iu garantuar ushtrim të funksionit jashtë mundësisë që kjo të kthehet në një mundësi shkarkimi nga një institucion i jashtëm.

---

277 Në këtë kuptim, **Kosova** hyn në pjesën dërrmuese të shteteve demokratike që nuk lejojnë shkarkimin e gjyqtarëve kushtetuese nga një organ i jashtëm jashtë vetë gjykatës kushtetuese. Në këtë grup të shteteve hyjnë edhe vendet si: **Austria, Belgjika, Bosnje-Hercegovina, Bullgaria, Danimarka, Gjermania, Hungaria, Islanda, Italia, Latvia, Lihtenshtajni, Kroacia, Malta, Polonia, Portugalia, Rumania, Spanja, Suedia, Turqia, Zvicra.**
Ka raste kur shkarkimin e bën autoriteti caktues i gjyqtarëve, me një vendim paraprak të vetë gjykatës. Kjo do të thotë se vendimi i autoritetit caktues ka fuqi juridike konstitutive, jo vendimi paraprak i gjykatës. Në rastin e **Kosovës** dhe vendeve të sipërcekura është e kundërta: vendimi i gjykatës që propozon shkarkimin e një gjyqtari kushtetues ka fuqi konstitutive dhe shefi i shtetit vetëm e aminon një vendim të tillë. Në këtë grup të shteteve, pra ku autoriteti caktues i gjyqtarëve kryen edhe shkarkimin e tyre hyjnë vendet si vijon: **Armenia, Maqedonia, Lituania** dhe **Sllovakia**. Në vendet tjera, ndërkaq, autoriteti shkarkues është i veshur në njërën prej dhomave të organit përfaqësues dhe ligjvënës. I tillë është rasti me, ta zëmë, Argjentinën**, Poloninë, Slloveninë, Kanadanë** etj. Në **Irlandë**, një gjë të tillë mund ta bëjë presidenti i Republikës sipas kërkesës së dy dhomave të parlamentit.
Procedurat e **impeachment**-it në disa shtete mund të jenë pjesë përbërëse e procesit të shkarkimit të gjyqtarit të një gjykate kushtetuese apo gjykate tjetër të lartë të barasvlefshme me gjykatën kushtetuese. I tillë është rasti me **Danimarkën, Finalndën, Japoninë** dhe **Lituaninë**. Cf. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *The Composition of Constitutional Courts,* fq. 18.

278 **Komisioni i Venecias** lidhur me këtë ka konstatuar se janë disa shkaqe për shkarkim të gjyqtarëve, mirëpo ka theksuar se e përbashkëta e tyre është se në çdo rast shkarkimi i gjyqtarëve kushtetues duhet të bëhet vetëm për shkaqe jashtëzakonisht të rënda dhe serioze. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *The Composition of Constitutional Courts,* Ibid. fq. 18.

279 Ibid. fq. 18.

280 Ibid. fq. 18-19.

281 Në rastet e sjelljeve të pahijshme, nga gjyqtarët e **Gjykatës Supreme Federale të Zvicrës** pritet që të japin dorëheqje. Mungesa e procedurave të shkarkimit të anëtarëve të gjykatës së lartë zvicerane ka lindur në vitin 2003, kur një komision parlamentar ka gjetur se një gjyqtarë i Gjykatës Supreme Federale kishte pështyrë një gazetarë dhe kishte thënë, si kryesues i panelit penal, se vendimi kishte qenë unanim në ndërkohë që një gjyqtar kishte qenë kundër vendimit. Ky komision parlamentar, pasi gjeti se me këto dy veprime, gjyqtari i lartë kishte kryer sjellje të pahijshme, konstatoi se, megjithatë, gjyqtarët e Gjykatës Supreme Federale nuk mund të shkarkohen. Në vend të kësaj, ky komision kërkoi nga gjyqtari që kishte bërë sjelljen e keqe të jap dorëheqje. Kjo nuk vlen për gjyqtarët e kantoneve, të cilët mund të shkarkohen për shkak të sjelljeve të këqija apo gjendjes së keqe shëndetësore. Cf. Benjamin Suter, "Appointment, Discipline and Removal of Judges: A Comparison of the Swiss and New Zealand Judiciaries" *Victoria University of Wellington Law Review* Vol. 46 No. 2 (2015) fq. 267-306 në fq. 298-300.

Përveç kësaj, kushti që propozimi i bërë për shkarkim të jetë prej dy të tretave (2/3) të gjyqtarëve (nga nëntë sa duhet të jenë në tërësi), bën që propozimi për shkarkim realisht të jetë shumë vështirë i arritshëm dhe që të ketë një konsensus shumë të gjerë në mes vet gjyqtarëve kushtetues për të propozuar shkarkimin e një gjyqtari. Në disa vende të **komonueltit britanik** ekzistojnë komisione të posaçme të pavarura që kanë autorizim për të shkarkuar gjyqtarët sipas një procedure mjaft transparente dhe të detajuar dhe duke u bazuar në shkaqe mjaft objektive për një gjë të tillë: në këto shkaqe hyjnë, përveç kushteve që janë të ngjashme me rastin e Kosovës nga neni 118 si më sipër, edhe paaftësia për të ushtruar funksionin e gjyqtarit si pasojë e gjendjes së keqe shëndetësore.[282]

Në vijim si më sipër, bazat kushtetuese për shkarkim të një gjyqtari kushtetues kosovar janë të njëjta me vendet tjera: një, për shkak të kryerjes së një krimi të rëndë; dhe, dy, për shkak të mospërfilljes së rëndë të detyrave. Në rastin e parë, propozimi për shkarkim sipas këtij neni duhet që të ketë bazë të besueshme gjyqësore që vlerëson që gjyqtari kushtetues ka kryer një krim të rëndë sipas legjislacionit penal. Në rastin e dytë, ky nen bën që çështja e disiplinimit të gjyqtarëve kushtetues të mund të bëhet nga vet kolegji i gjyqtarëve, dhe që, për të dhënë propozimin për shkarkim, duhet që të ketë një bazë të arsyetuar që evidenton shkeljet disiplinore të bëra nga ana e gjyqtarit kushtetues që propozohet për shkarkim tek **Presidenti i Republikës**. Në përgjithësi, nga kjo del se gjyqtarët kushtetues janë shumë të mbrojtur nga shkarkimi. Realisht ky nen kushtetues i mbron ata prej dhënies së përgjegjësisë institucioneve jashtë Gjykatës si mënyrë për tu mbrojtur prej shkarkimit eventual.

Sa i përket kushteve shtesë për shkarkim të vëna me rregullin nr. 6 të **RP**, vlen të theksohet se ato janë të njohura edhe në vendet tjera dhe paraqesin rrethana jetësore jashtë vullnetit të gjyqtarit kushtetues. Në fakt, shkaqet e vëna për shkarkim të gjyqtarëve kushtetues në rregullën nr. 6 si më sipër nuk janë veçse shkaqe standarde që i gjejmë edhe në sistemet tjera juridiko-kushtetuese. Në këtë kuptim, të gjitha shkaqet për shkarkim, të vëna në këtë dispozitë dhe në vendet tjera, si në ato të **sistemit kontinental** ashtu dhe në vendet e sistemit të së **drejtës së përgjithshme**, mund të ndahen, **grosso modo**, në dy grupe: në grupin e parë hyjnë shkaqet për shkarkim të cilat janë krijuar me vetëdije dhe qëllimisht nga vetë gjyqtari që propozohet të shkarkohet, kurse në grupin e dytë janë shkaqet që janë ndërtuar jashtë vullnetit dhe pa vetëdije (qëllim) të gjyqtarit që shkarkohet.[283] Në grupin e parë të shkaqeve për shkarkim si më sipër bëjnë pjesë, ta zëmë, shkaqet që kanë të bëjnë me rastet e kryerjes së ndonjë krimi të rëndë dhe rastet e të mospërfilljes së rëndë të detyrave të punës nga ana e gjyqtarit kushtetues, siç parashihet në pikën rregullin 6.1 nën "a" dhe "b" të **RP**. Në grupin e dytë të shkaqeve, ndërkaq, hyjnë dy rastet tjera nga germat nën "c" dhe "d" të paragrafit të njëjtë të rregullit nr. 6 të **RP** dhe mbulojnë situatat e krijuara nga rastet e humbjes së përhershme të aftësisë për të vepruar, ose rastet e sëmundjes a të ndonjë problemi tjetër shëndetësor, që e bën të pamundur ushtrimin e përgjegjësive dhe të funksionit të gjyqtarit kushtetues.

---

[282] Dane Ally, "A Comparative Analysis of the Constitutional Frameëorks for the Removal of Judges in the Jurisdictions of Kenya and South Africa". *Athens Journal of Law* Vol. 2 No. 3 (July 2016) fq. 137-157 (autori duke diskutuar rastet e **Kenias** dhe **Afrikës së Jugut**, si dy vende tipike që modelohen sipas sistemit britanik të së drejtës së përgjithshme apo **common law**, jep një analizë komparative të çështjes së shkarkimit në nivel regjional dhe universal; në këtë kuptim, autori konstaton se transparenca, caktimi i kushteve për shkarkim në mënyrë objektive, si dhe sigurimi i një gjykimi të drejtë dhe të paanshëm të rasteve të shkarkimit, provojnë një veçori të përgjithshme të të gjitha sistemeve demokratike).

[283] Jack E. Frankel, "Removal of Judges: California Tackles an Old Problem." *American Bar Association Journal*, Vol. 49, No. 2 (February 1963), fq. 166-171 në veçanti fq. 167-168 (autori diskuton shkaqet për shkarkim sipas praktikës së shteteve anëtare të **SHBA**-ve, mirëpo fokusi kryesor është **Kalifornia**; sipas diskutimit, qartë shihet se fjala është për dy shkaqe: i pari, sjellja e turpshme dhe jodinjitoze e gjyqtarit; dhe, i dyti, paaftësia mendore dhe tjetër që buron nga shkaqet e shëndetit të keq të gjyqtarit; këto dy shkaqe diskutohen krahas shkaqeve që kanë të bëjnë me veprat penale dhe procedurat e **impeachment**-it të gjyqtarëve; kjo e fundit, pra procedura për **impeachment**-in e gjyqtarëve nuk konsiderohet si e mjaftueshme për arritjen e qëllimit të duhur: shkarkimin e gjyqtarëve kur nuk sillen mire dhe kanë problem me shëndetin); Cf. edhe përmbledhjet si vijon: The Commonwealth, *The Appointment, Tenure and Removal of Judges under Commonwealth Principles. A Compendium and Analysis of Best Practice* (The British Institute of International and Comparative Law: London, 2015) fq. 79, 82-88; Elliot Bulmer, Judicial **Tenure, Removal, Immunity and Accountability** (International Institute for Democracy and Electoral Assistance/ International IDEA: Stockholm, 2017) fq. 11.

Vlen të theksohet se këto dy grupe të shkaqeve janë përgjithësisht të pranuara edhe në planin ndërkombëtar: në vitin 1985 **Asambleja e Përgjithshme e OKB**-së ka nxjerrë dy rezoluta më të cilat ka përkrahur ekzistimin e vetëm dy llojeve të shkaqeve për përjashtim si më sipër.[284] Ka raste kur shtete parashikojnë shkaqe shtesë për shkarkim, siç janë jokomepetenca e gjyqtarit, sjellja e kundërt me kodin gjyqësor apo kodin e etikës: në rastet kur këto kode parashikojnë masën e shkarkimit sipas këtyre dy bazave (sjellja joetike apo jogjyqësore), atëherë lindin shqetësime të mëdha. Standardi që duhet të aplikohet konsiston në atë se me ligj duhet të parashikohen dhe precizohen shkaqet për shkarkim, jo me kode etike apo me kode të tjera që përmbajnë norma morale të përgjithësuara dhe mega-abstrakte të sjelljes gjyqësore.[285]

Ndarja si më sipër nuk është edhe aq e sakët sepse ka raste kur një shkak për shkarkim ka rrënjët e veta jashtë vullnetit dhe vetëdijes së gjyqtarit që shkarkohet, në ndërkohë që gjyqtari i tillë fare nuk ka kontribuar në krijimin e atij shkaku. I tillë është rasti me shkaqet që krijohen nga pushteti për motive politike, siç është rasti me shkarkimin e pashembullt të dy gjyqtarëve kushtetues në **Turqi** më datën 4 gusht 2016, pas **puçit** të dështuar ushtarak kundër presidentit turk **Rexhep Taip Erdogan** në korrik të po atij viti.[286] Shkarkimi në fjalë më shumë ka pasur të bëjë me dëbimin e dhunshëm dhe inkriminimin e tyre me qëllim të spastrimit të Gjykatës Kushtetuese nga të padëgjueshmit.[287] Si i tillë, ai është bazuar në tërësi në premisa arbitrare të bindjes së imponuar me dhunë të ish kolegëve të tyre dhe jashtë kompetencave kushtetuese për shkarkim të gjyqtarëve: gjyqtarët kushtetues në këtë vend kanë mundur të shkarkohen, sipas kushtetutës në fuqi, vetëm në bazë të një vendimi që provon fajësinë e gjyqtarit si dhe për shkak të sëmundjes së rëndë që pamundëson kryerjen e detyrave si gjyqtar.[288] Ligji ka përcaktuar një kusht shtesë: Gjykata Kushtetuese mund të kërkoj me një votim prej dy të tretave që një anëtar i saj të tërhiqet për shkak të sjelljeve të pahijshme dhe të padinjitetshme që fyejnë nderin dhe betimin e dhënë

---

284 "[...] 18. Gjyqtarët mund të suspendohen apo shkarkohen vetëm për shkaqe që kanë të bëjnë me paaftësinë apo sjelljen e tyre që i bënë të papërshtatshëm për kryerjen e detyrave të tyre [...]". **UN Basic Principles on the Independence of the Judiciary**. Në internet: https://www.un.org/ ruleoflaw/ blog/ document/ basic-principles-on-the-independence-of-the-judiciary/ (shikuar në prill 2018).

285 The Commonwealth, *The Appointment, Tenure and Removal of Judges under Commonwealth Principles. A Compendium and Analysis of Best Practice*, fq. 85-86.
Sa i përket procedurave për shkarkim, ato dallojnë në dy sistemet e së drejtës: në **sistemin civil - kontinental** më shumë preferohet shkarkimi në bazë të vendimit gjyqësor dhe komisioneve disiplinore kurse në sistemin e **të drejtës së përgjithshme** (**common law**) preferohet shkarkimi në bazë të vendimit të parlamentit, përkatësisht përmes procedurave të **impeachement**-it. Cf. Elliot Bulmer, *Judicial Tenure, Removal, Immunity and Accountability*, fq. 9-11; Shkarkimi përmes **impeachment**-it përkatësisht përmes procedurave parlamentare ka rrënjë mesjetare dhe është ruajtur në origjinalitetin e vet kryesisht në SHBA: atje, procedura e impeachment-it ende vazhdon të jetë e vetmja sa i përket shkarkimit të gjyqtarëve federal. Cf. më shumë për këtë në James E. Pfander, "Removing Federal Judges", fq. 1227-1250 (autori argumenton se hartuesit e kushtetutës amerikane kanë qenë përkrahës vetëm të një mënyre për shkarkimin e gjyqtarëve federal, **impeachment**-it, traditë kjo që ka nisur në kohën e kolonializmit anglez me të ashtuquajturin **Judicial Settlement Act** *të vitit 1701; autorët vërtetojnë katërcipërisht se kjo përvojë, e nisur fillimisht nëpër shtetet anëtare, në tërësi reflektohet dhe është bartur në nivel federal sepse kushtetuta amerikanë parashikon një rol të veçantë për* **Senatin** *në administrimit dhe ekzekutimin e procedurave të* **impeachment**-it; kjo procedurë ngelet e vetmja procedurë valide për shkarkimin e gjyqtarëve federal).

286 Fjala është për gjyqtarët **Alparslan Altan** dhe **Erdal Tercan**. Baza juridike për shkarkimin e dy gjyqtarëve kushtetues turk më datën 4 gusht 2016 ka qenë neni 3 i Dekret-ligjit nr. 667 të datës 23 korrik 2016, i cili ka autorizuar **Gjykatën Kushtetuese të Turqisë** që të shkarkoj çdo gjyqtarë që ka lidhje me grupe terroriste. Dy këta gjyqtarë janë arrestuar më datën 18 korrik 2016, pra para nxjerrjes së dekretit ën fjalë që autorizon shkarkimin mbi bazën e sipërcekur. Cf. Tarik Olcay, "Firing Bench-mates: The Human Rights and Rule of Law Implications of the Turkish Constitutional Court's Dismissal of Its Tëo Members Decision of 4 August 2016, E. 2016/6 (Miscellaneous file), K. 2016/12". *European Constitutional Law Review* Vol. 13 Issue 3 (September, 2017) fq. 568–581 në fq. 569-573.

287 Ibid. fq. 575.

288 Neni 47 ["Përfundimi i Mandatit"[i Kushtetutës:
"Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese pensionohen në moshën gjashtëdhjetë e pesë vjeçare. Anëtarësimi në Gjykatë Kushtetuese pushon në mënyrë automatike nëse një anëtar dënohet për një vepër ku kërkohet largimi nga profesioni i gjyqësorit., si dhe me një vendim të shumicës absolute të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese me të cilin konstatohet se gjyqtari ka humbur aftësinë për të kryer detyrat për shkak të gjendjes së keqe shëndetësore". **Constitution of Turkey of 1982 with Amendments through 2017.** https://global. tbmm. gov. tr / docs/ constitution _en.pdf (shikuar në prill 2018).

si gjyqtar kushtetues.[289] Nga kjo shihet se nuk ekziston baza kushtetuese e ligjore për dëbim arbitrar të gjyqtarit kushtetues.[290] Në rastin konkret, asnjë nga këto procedura kushtetuese nuk janë zbatuar: asnjë e drejtë për ankesë, prezumim i pafajësisë apo gjykim i drejtë dhe i paanshëm nuk është respektuar.[291] Për të qenë e keqja edhe më e madhe, vendimi i Gjykatës Kushtetuese i datës 4 gusht 2017 për përjashtimin e dy ish-kolegëve të vet ka shërbyer si bazë për përjashtimin masiv të mijëra gjyqtarëve, prokurorëve dhe zyrtarëve të tjerë turq.[292] Kjo nuk ka qenë fytyra e kësaj Gjykate para këtyre ngjarjeve dramatike: para puçit të dështuar ushtarak, ajo ka marrë vendime shumë domethënëse dhe të pavarura që kanë frenuar ambiciet për qeverisje arbitrare dhe uzurpim autoritar të pushtetit të presidentit aktual turk, të kryera jashtë parametrave kushtetues të demokracive perëndimore liberale.[293] Këtë e kemi diskutuar më herët kur kemi folur për **Gjykatën Kushtetuese të Turqisë** dhe për historinë e zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese në këtë vend.[294]

12.4. Komente dhe pyetje

12.4.1. Përbërjet e përziera të gjykatave kushtetuese janë të rralla. Kjo sepse gjykatat zakonisht përbëhen nga gjyqtarët vendorë që janë shtetas të shtetit të cilit i takon vetë ajo. Ka raste, megjithatë, kur në përbërjen e një gjykate kushtetuese ka edhe gjyqtarë të huaj. Kjo quhet **gjyqësi hibride kushtetuese**. Në ish-Jugosllavi, ky lloj gjyqësie ka nisur me Bosnje-Hercegovinën pas **Marrëveshjes së Dejtonit** (1995). Cilat janë llojet e gjyqësisë kushtetuese hibride dhe cilat janë synimet e saj parësore?

12.4.2. Në Kosovë, gjyqësia kushtetuese hibride nisi me **Planin Ahtisari**. Ky lloj i gjyqësisë kushtetuese, megjithatë, ka vazhduar edhe pas mbarimit të pavarësisë së mbikëqyrur në shtator të vitit 2012. Cila ka qenë baza juridike për vazhdimin e mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë në vitet 2012-2014 dhe cila pas vitit 2014? Tregoni në veçanti cilat aspekte të caktimit të tyre kanë qenë kontestuese në publik dhe për çfarë arsye?

12.4.3. Për ekzistimin e modelit **evropian/kelsenian** të gjyqësisë kushtetuese duhet të ekzistojnë disa cilësi, dy nga të cilat janë më të rëndësishmet: e para ka të bëj me sistemin e qeverisjes (parlamentar apo gjysmë-parlamentar) kurse e dyta me pluralizmin e juridiksioneve. Këto dy cilësi i ka pasur parasysh **Kosova** kur ka përqafuar modelin **evropian/kelsenian** të gjyqësisë kushtetuese përmes **Planit Ahtisari** dhe me Kushtetutë. Çfarë do të thotë kjo?

12.4.4. Aktualisht ekzistojnë disa sisteme për caktimin e gjyqtarëve kushtetues, të cilat dallojnë ndërmjet veti sipas asaj se kush dhe si i cakton gjyqtarët kushtetues. Sipas **Hans Kelsen**, organi caktues i gjyqtarëve kushtetues duhet të jetë i natyrës politike. Çfarë do të thotë ky përcaktim i **Hans Kelsen**? Cilat

---

289 Cf. neni n 11 ["Vendet vakante dhe ndërprerja e mandatit"] lidhur me nenin 19 ["Sanksionet disiplinore dhe ekzekutimi i tyre"] i **Ligjit Nr. 6216 për Gjykatën Kushtetuese** (2011). Në internet: http://www. constitutionalcourt.gov.tr/inlinepages/legislation/LawOnConstitutionalCourt.html (shikuar në prill 2018)

290 Ibid. fq. 574-576 (ku autori shpjegon në hollësi procedurat ekzistuese për shkarkimin e gjyqtarëve kushtetues, të cilat formalisht ende janë në fuqi dhe mënyrën se si Dekret-ligji nr. 667 ka imponuar procedura arbitrare për shkarkim, të cilat në tërësi janë jokushtetuese).

291 Tarik Olcay, "Firing Bench-mates: The Human Rights and Rule of Law Implications of the Turkish Constitutional Court's Dismissal of Its Two Members Decision of 4 August 2016, E. 2016/6 (Miscellaneous file), K. 2016/12", fq. 573-576; Për standardin e gjykimit të drejtë dhe të paanshëm të rasteve të shkarkimit të gjyqtarëve në vendet e sistemit të së **drejtës së përgjithshme** (**common law**), cf. më shumë në The Commonwealth, *The Appointment, Tenure and Removal of Judges under Commonwealth Principles. A Compendium and Analysis of Best Practice,* fq. 88-90.

292 Ibid. fq.577-578; European Commission for Democracy through Law (Venice Commission), *Turkey. Opinion on Emergency Decree Laws Nos. 667-676, Adopted Following the Failed Coup of 15 July 2016.* Adopted by the Venice Commission at its 109th Plenary Session (Venice, 9-10 December 2016). **Opinion No. 865/2016**. Strasbourg, 12 December 2016. CDL-AD (2016)037. Engl.only. Paragrafët 137-140. Në internet:http://www.venice.coe.int/ webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)037-e (shikuar në prill 2018).

293 European Commission for Democracy through Law (Venice Commission), *Turket. Opinion on Emergency Decree Laws Nos. 667-676,* paragrafët 64-65 & 188-190.

294 Cf. seksionin 8.1 të kapitullit tetë të këtij libri.

janë tri sistemet e caktimit të gjyqtarëve kushtetues aktualisht? Në veçanti tregoni se cilit model i ka takuar **Kosova** gjatë pavarësisë së mbikëqyrur (shkurt 2008 – shtator 2012)?

12.4.5. Nga analiza komparative del se në demokracitë kushtetuese liberale, të vjetra dhe të reja, kushtetutat nacionale i normojnë bazat themelore të pavarësisë dhe statusit të gjyqtarëve kushtetues, kurse ligjet organike apo ligjet tjera i specifikojnë më tutje normat kushtetuese që garantojnë pavarësinë organizative dhe statusore të gjyqësorit, përfshirë këtu gjyqësorin kushtetues. Si duken këto aspekte institucionale të statusit të gjyqtarit në kontekstin kosovar të gjyqësisë kushtetuese? Diskutoni!

12.4.6. Në Kosovë, papajtueshmëria në kuptimin **objektiv** (funksional) përcaktohet dhe normohet me **Ligjin nr. 03/L-121**, jo me **RP**, dhe atë vetëm me një nen të tij. Ai nen është neni 5 ["Papajtueshmëria e funksionit"] dhe flet për papajtueshmërinë **objektive** (funksionale) në një mënyrë mjaft të qartë. Pengesat e përshkruara në këtë nen janë rrethana që formojnë papajtueshmërinë, e cila mund të shfaqet si me rastin e fitimit (zgjedhjes dhe emërimit) ashtu dhe gjatë kohës së ushtrimit të postit të gjyqtarit kushtetues. Thënë me fjalë të tjera, neni 5 normon papajtueshmërinë si me rastin e fitimit të postit (zgjedhjes dhe emërimit) ashtu edhe gjatë kohës së të qenit gjyqtar kushtetues. Tregoni rastin e vetëm të papajtueshmërisë **objektive** (funksionale) të një gjyqtari kushtetues në **Gjykatën Kushtetuese** për të cilin ka vendosur, si dhe kohën kur është shfaqur një papajtueshmëri e tillë (gjatë kohës së ushtrimit të funksionit si gjyqtar kushtetues apo para fitimit të këtij posti)?

12.4.7. Në rastin e vetëm në të cilin **Gjykata Kushtetuese** ka vendosur për papajtueshmërinë në kuptimin **objektiv** (funksional) ka bërë dallimin në mes të, në njërën anë, pavarësisë së gjyqtarit dhe, në anën tjetër, paanësisë në vendimmarrje të gjyqtarëve kushtetues. Në ndërkohë që në rastin e parë flitet për kufizime të përgjithshme dhe parimore që kanë fuqi **objektive** veprimi, si në kohë ashtu dhe në hapësirë, në rastin e dytë bëhet fjalë për paanësinë e gjyqtarit si një gjendje **subjektive** që përcaktohet nga marrëdhënia e saj/tij me rastin apo palët në procedim e sipër. Si rregullohet kjo në rastin e Kosovës? Cili është dallimi thelbësor në mes këtyre dy koncepteve? Si normohet kjo në jurisprudencën komparative në veçanti sa i përket angazhimit politik të gjyqtarëve, si në të kaluarën ashtu dhe aktualisht?

12.4.8. Njoftimi i rasteve kur njëri prej gjyqtarëve të **Gjykatës Kushtetuese** është duke ushtruar ndonjë post tjetër publik ose profesional për të cilën shpërblehet me pagesë pas marrjes së detyrës së gjyqtarit, duhet të bëhet përmes vetëdeklarimit të saj/tij: gjyqtari duhet menjëherë, pa shtyrje, ta informoj kryetarin e Gjykatës për një gjë të tillë. A do të thotë kjo se gjyqtarët kushtetues asnjëherë nuk mund të merren me poste të tjera publike ose profesionale? Si është e rregulluar kjo në jurisprudencën komparative?

12.4.9. Para caktimit si gjyqtar, përkatësisht para dhënies së betimit para **Presidentit të Republikës** dhe marrjes së dekretit për emërim, kandidati i zgjedhur nga Kuvendi duhet të japë dorëheqje nga postet (funksionet) e përcaktuara nga dy paragrafët e para të nenit 5 të **Ligjit nr. 03/L-121.** Kështu thuhet në paragrafin e tretë të këtij Ligji. Dorëheqja i paraqitet **Presidentit të Republikës.** Cila duhet të jetë arsyeja që dorëheqja i paraqitet një organi pranë të cilit kandidati për gjyqtar ende nuk e ka dhënë betimin për t'u bërë gjyqtar kushtetues në kuptimin formal?

12.4.10. Privilegjet paraqesin masa ligjore me qëllim të krijimit të lehtësirave për gjyqtarët kushtetues në mënyrë që ato/ata të ushtrojnë në mënyrë efektive funksionin e gjyqtarit kushtetues. Për dallim nga **imunitetet**, **privilegjet** nuk janë të domosdoshme sepse edhe pa ekzistimin e tyre gjyqtarët kushtetues mund të ushtrojnë funksionet e tyre. Çfarë do të thotë kjo? Në çfarë konsistojnë privilegjet dhe cilat janë disa nga to që njihen në Kosovë dhe si rregullohet çështja e tyre në jurisprudencën komparative?

12.4.11. Gjatë mandatit si kryetar i parë i **Gjykatës Kushtetuese**, autori i parë i librit, përmes zyrës së protokollit në Gjykatë çdoherë ka dërguar për vizita kortezie gjyqtarët dhe kryetarët e huaj vetëm

te Presidenti i Republikës dhe Kryetari i Kuvendit, asnjëherë te shefi i ekzekutivit kosovar. Cila është arsyeja profesionale për një gjë të tillë?. Po ashtu, në ceremonitë e vitit gjyqësor kushtetues, si dhe në ceremonitë tjera të **Gjykatës Kushtetuese** nuk janë ftuar asnjëherë zyrtarët e ekzekutivit kosovar. Po ashtu, as fotografia e **Presidentit të Kosovës**, e cila sipas ligjit duhet të vihet nëpër institucionet republikane, nuk është vënë në hapësirat e Gjykatës. Kjo ka një shpjegim **që lidhet me juridiksionin dhe palët e autorizuara. Çfarë don të thotë kjo? Cilën qasje përqafojnë vendet tjera, përkatësisht cilat janë standardet komparative në këtë drejtim?**

12.4.12. Kosova nuk ua njeh gjyqtarëve të saj kushtetues **imunitetin e paprekshmërisë.** Çfarë do të thotë kjo? Cili është dallimi në mes të këtij imuniteti dhe **imunitetit funksional**? Cili ka qenë trendi i ish-vendeve komuniste, përkatësisht cilin lloj të imunitetit e kanë përqafuar ato në masën më të madhe? Cili vend i demokracive tradicionale evropiane ka përqafuar **imunitetin e paprekshmërisë** për gjyqtarët e vet kushtetues?

12.4.13. Në rastin **KO 98/11,** Gjykata Kushtetuese ka shtjelluar në mënyrë shteruese dhe komparative çështjen e imunitetit funksional të funksionarëve të lartë shtetëror. Diskutoni, në veçanti duke analizuar dëshminë e rrejshme të dëshmitarit ndërkombëtar **Robert Carolan** dhe vendimmarrjen në rastin **KO 155/14**. Merrni vendimet e Gjykatës për këto dy raste dhe analizoni me kujdes ato, para së të nis diskutimi juaj!

12.4.14. Me deklaratën e tij të rrejshme, dhënë pranë ushtruesit të detyrës së **Avokatit të Popullit** dhe Prokurorisë Speciale të Kosovës, gjyqtari kushtetues ndërkombëtar, **Robert Carolan** zbuloi një kategori dhe institut të ri, i cili në diskursin dhe praktikën juridiko-kushtetuese kosovare nuk ka qenë i njohur asnjëherë. Në fakt, ai nuk ka qenë i njohur asnjëherë në dy anët e **Atlantikut.** Fjalën e kemi për institutin e a.q. **vetpërjashtimi i gjyqtarit.** Diskutoni këtë institut nga aspekti komparativ dhe përgjigjen të cilën gjykatat kosovare e kanë dhënë, deri te **Gjykata Supreme e Kosovës**, ndaj këtij instituti të krijuar në mënyrë **fiktive** përmes dëshmisë së rrejshme të gjyqtarit në fjalë ndërkombëtar. Në veçanti ka rëndësi të bëni dallimin në mes të **iudex inhabilis** dhe **iudex suspectus**, dallim ky që gjendet në të gjitha sistemet juridike të demokracive bashkëkohore në dy anët e **Atlantikut**.

12.4.15. Në rastet kur të gjithë duhen skualifikuar, askush nuk skualifikohet. Kjo thënie e njohur dhe shumë lakonike në jurisprudencën amerikane përbën thelbin e doktrinës së njohur mbi **rregullin i domosdoshmërisë** (**rule of necessity**). Kur dhe si ka lindur kjo rregull? Cila është përmbajtja e saj dhe si e ka trajtuar këtë rregull **Komisioni i Venecias**, në veçanti në kontekstin e **lustrimit** dhe **vetingut** shqiptar?

12.4.16. Shkaqet për shkarkim të gjyqtarëve kushtetues janë të ndryshme. Në shumicën e shteteve demokratike, vetë gjykata kushtetuese ngelet si protagonist kryesor në procesin e shkarkimit të gjyqtarëve, përkatësisht në procesin e vlerësimit nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara me kushtetutë e ligj për shkarkimin e një gjyqtari kushtetues. Ka raste kur shtetet përcaktojnë procedura të tjera në të cilat gjykatat kushtetuese nuk kanë një rol në këtë proces. Në skajin e fundit janë shtetet që fare nuk kanë dispozita për shkarkim të gjyqtarëve kushtetues, përkatësisht të gjyqtarëve të lartë të barasvlefshëm me gjyqtarët kushtetues. Diskutoni këto aspekte të praktikave të shkarkimit me fokus të veçantë në rastin e **Kosovës.**

12.4.17. Gjyqtari ndërkombëtar Robert Carolan, pasi u bë dëshmitar i rrejshëm, mori mandatin edhe për dy vitet në vijim dhe më pastaj nisi skandalin në të cilin tregohet se si atij iu paska pas falsifikuar nënshkrimi, se si paska pas bërë vetë përjashtim nga vendosja e rastit që ia vazhdonte mandatin edhe për dy vite, për shkak të gjoja konfliktit të interesit dhe shumë përralla të tjera. Krejt kjo dëshmi e rreme në fund ngeli mbi supet e ish-kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, autorit të parë të këtij libri: ai u hetua, u akuzua dhe krejt instancat gjyqësore thanë në fund se ishte persekutuar pa të drejtë. Akuzat ndodhën pas mbarimit të mandatit të tij në qershor të vitit 2015 dhe nisnin hapur me akuza se kishte rrëzuar kryeprokurorin e shtetit nga detyra. Shkarkoni vendimet që kanë rrëzuar nga detyra kryeprokurorin e shtetit, **Aleksandër Lumezi**, dhe analizoni mirë përmbajtjet e tyre. E kemi fjalën për *Rastet KI 199/14*

dhe KI 100/14. Aktgjykim. Parashtrues: Shyqyri Syla dhe Laura Pula. Vlerësim i kushtetutshmërisë se vendimeve te Këshillit Prokurorial te Kosovës lidhur me procedurën e zgjedhjes se Kryeprokurorit te Shtetit (**Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Nr. ref.: A GJ 679/14. Prishtinë, 8 korrik 2014). Ekziston një arsye e qartë pse nuk diskutohen më në detaje nga autorët e librit këto dy raste të rrëzimit të Kryeprokurorit të Shtetit, **Aleksandër Lumezi.** Diskutoni!

12.5. Lexim shtesë

- Mauro Capelleti, "Necessite e legitimite de la justice constitutionelle". *Revue internationale de droit compare* Vol. 33 No. 2 (Avril-juin 1981);
- Theodore Holo, "Emergence de la justice constitutionelle". *Pouvoirs* Vol. 2 No. 129 (2009);
- Visar Morina, "The Newly Established Constitutional Court in Post-Status Kosovo: Selected Institutional and Procedural Concerns". *Review of Central and East European Law* Vol. 35 Issue 2 (2010);
- Visar Morina, Fisnik Korenica and Dren Doli, "The relationship between international law and national law in the case of Kosovo: A constitutional perspective ". *International Journal of Constitutional Law* Vol. 9 No. 1 (2011);
- Milan Podunavac & Biljana Dordevic, *Ustavi u vremenu krize* (Univerzitet u Beogradu, Fakultet politickih nauka: Beogrda, 2014);
- Visar Morina, "The Legal Prospective Force of Constitutional Courts Decisions: Reflections from the Constitutional Jurisprudence of Kosovo and Beyond". *Nottingham Law Journal* Vol. 25 (2016);
- Visar Morina, *Gjyqësia Kushtetuese. Shqyrtime teorike dhe krahasimore* (Universiteti i Prishtinës: Prishtinë, 2018).

13. *STARE DECISIS* SI DETYRIM KUSHTETUES I AUTORITETEVE PUBLIKE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Përgjithësisht. - Për të diskutuar rolin dhe pozitën e **stare decisis** në gjyqësinë kushtetuese kosovare, me një vështrim të veçantë në detyrimin kushtetuese të autoriteteve publike kosovare për të vënë në jetë precedentet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (**GJEDNJ**), ky kapitull ndahet në katër seksione.

Për dallim nga kapitujt pararendës, këtu sqarohen paraprakisht disa gjëra rreth konceptit të doktrinës **stare decisis**, si parim dhe burim i së drejtës që gjen zbatim të përgjithshëm në sistemin e të **drejtës së përgjithshme** (**common law**) dhe përdorim të kufizuar dhe krejt specifik në **sistemin civil (kontinental)**. Në këtë të fundit hyn edhe **Kosova**. Besojmë se lexuesi ynë do ta gjejë të dobishëm diskutimin në vijim për gjërat themelore rreth kuptimit, lindjes, zhvillimit, vendit dhe rëndësisë që ka fituar ky koncept, në mënyrë graduale, në gjyqësinë kushtetuese bashkëkohore. Seksioni i parë i këtij kapitulli nis pikërisht me trajtimin e gjërave themelore rreth lindjes, kuptimit dhe zhvillimi të **stare decisis**.

Seksioni i dytë në vijim flet për statusin kushtetues të lirive dhe të drejtave të njeriut në përgjithësi, me vështrim të veçantë në rastin e **Kosovës**. Ka rëndësi që lexuesi ynë të shoh nga afër se liritë dhe të drejtat e njeriut, siç janë të sanksionuara me dokumentet e instrumentet kryesore regjionale dhe ndërkombëtare, në vendin tonë kanë një status jashtëzakonisht të privilegjuar. Një status të tillë e kanë vetëm edhe në një vend tjetër të **Evropës**, në **Bosnje- Hercegovinë**. Ky status i privilegjuar, me disa ndryshime, ekziston edhe në vendet tjera ish-komuniste. Në rastin e **Kosovës** (dhe të **Bosnje-Hercegovinës**), megjithatë, statusi i privilegjuar manifestohet dhe konsiston në njohjen e statusit të normave kushtetues që kanë zbatim të drejtpërdrejtë në rendin e brendshëm të disa prej dokumenteve dhe instrumenteve kryesore evropiane dhe ndërkombëtare që normojnë liritë dhe të drejtat e njeriut. Ky pozicion kushtetues në **Kosovë** (dhe **Bosnje-Hercegovinë**) rrjedh si pasojë imediate e të kaluarës tragjike të të dyja vendeve dhe ka për synim parësor transformimin e tyre në shoqëri në të cilat sundon demokracia, kushtetuta e ligji, të drejtat e njeriut dhe ndarja e pushteteve. Fokusin në individin dhe marrëdhënien e tij me pushtetin përbën, në thelb, cilësinë dalluese të krejt vendeve që modelohen sipas projektit konstitucional liberal perëndimor.

Sa i përket pjesës tjetër të së drejtës ndërkombëtare, përfshirë dokumentet e instrumentet tjera evropiane e ndërkombëtare që nuk gëzojnë status të normës kushtetuese me zbatim të drejtpërdrejt, ndaj tyre Kosova ka një **qëndrim shumë miqësor**, njëjtë si vendet tjera **ish-komuniste**. Në këtë aspekt, nuk ekziston ndonjë dallim në mes të Kosovës dhe vendeve të tjera komuniste.

Seksioni i tretë ndahet në tri nënseksione dhe trajton fushëveprimin e **stare decisis** të **GJEDNJ** në praktikën gjyqësore të **Gjykatës Kushtetuese**. Këtu, thënë me fjalë të tjera, trajtohen caqet praktike të zbatimit të **stare decisis** që prodhohet në **Strasburg.** Ky seksion ndahet në tri nënseksione, ku preken të gjitha aspektet e caqeve të zbatimit të **stare decisis** me origjinë nga **Strasburgu** dhe atë:

- e para, trajtimi i **stare decisis** në procedurën e caktimit të masave të përkohshme;
- e dyta, trajtimi i **stare decisis** në pranueshmërinë e kërkesës; dhe, së fundi,
- e treta, trajtimi i **stare decisis** në procedurën e vendosjes lidhur me meritat e rastit.

Fushëveprimi i **stare decisis** të **GJEDNJ** qartë përcaktohet me dispozitat e Kushtetutës, sipas së cilës precedentet me origjinë nga **Strasburgu** gëzojnë statusin e një standardi kushtetues. Statusi i fuqishëm juridiko-kushtetues i lirive dhe të drejtave të njeriut në **Kosovë shprehet në detyrimin e** autoriteteve

publike kosovare për të mbështetur vendimet e tyre për liritë dhe të drejtat kushtetuese duke u mbështetur në standardet e interpretimit që prodhohen në praktikën gjyqësore të **GJEDNJ**. Ky mekanizëm kësisoj, i cili garanton epërsinë absolute të standardit të prodhuar në **Strasburg** në lëmin e lirive dhe të drejtave të njeriut, në të njëjtën kohë shërben si përcaktues i caqeve të veprimit të **stare decisis** ndër ne. Ai ankorohet në dispozitën e nenit 53 ["Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut"] të Kushtetutës, i cili përcakton si vijon:

"Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut."

Nga ky redaktim, krejtësisht unikat prodhohen disa pasoja juridiko-praktike. Në rend të parë, **stare decisis** përbën një burim formal të së drejtës kushtetuese kosovare. Së dyti, ai burim formal nuk ankorohet në praktikën e gjyqësisë kushtetuese kosovare dhe në praktikën tjetër gjyqësore kosovare, por në praktikën e **GJEDNJ**, si një institucion botërisht i pranuar si më i miri në fushën e vënies në jetë të lirive dhe të drejtave individuale. Së treti, **stare decisis** si burim formal ka efekt të drejtpërdrejtë sepse statusi i tij sanksionohet me normë kushtetuese, siç sanksionohet zbatimi i drejtpërdrejtë i vetë Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (**KEDNJ)**, dokument të cilin **Strasburgu** e ka detyrim parësor që ta interpretojë. Dhe, së fundi, **stare decisis** nuk ka të bëjë vetëm me gjyqësinë kushtetuese, por edhe me gjyqësinë e rregullt dhe me çdo autoritet tjetër publik kosovar që ka autorizime kushtetuese për të vendosur lidhur me liritë dhe të drejtat e njeriut. Në këtë kuptim, **Gjykata Kushtetuese** është e barabartë me gjyqësorin e rregullt dhe me çdo autoritet tjetër publik që ka autorizime kushtetuese e ligjore për të vendosur lidhur me liritë dhe të drejtat e garantuara kushtetuese. Në këtë kuptim, marrëdhëniet e secilit autoritet publik kosovar ndaj detyrimit sipas nenit 53 të Kushtetutës është vertikal dhe paralel, sipas peshës kushtetuese që ka secili organ kushtetues në **Kosovë**. Kjo marrëdhënie, në një mënyrë, i ngjason marrëdhënies që kanë me diellin planetët dhe trupat tjerë qiellor, ku përcaktues për dallimin e tyre është fuqia gravituese e planetëve dhe trupave të tjerë qiellorë. Në këtë kuptim metaforik dhe lakonik, **Gjykata Kushtetuese** paraqitet si organi kushtetues **me peshën më të madhe gravitacionale** kundrejt praktikës gjyqësore të **Strasburgut** sepse ka rol të dyfishtë: së pari, të ndjekë precedentët që prodhohen atje dhe, së dyti, vetë të shërbejë si një vënës i standardeve për të gjitha organet tjera kushtetuese të **Kosovës** që ushtrojnë autorizime publike. Në rast konflikti, nuk do mend për t'u kuptuar, mbizotëron standardi i vënë në Strasburg, pikërisht për shkak të detyrimit kushtetues nga neni 53 i Kushtetutës.

Në këtë pjesë hyrëse, theksojmë se **stare decisis** duhet të dallohet nga efekti juridik i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Në rastin e efektit juridik të vendimeve, që normohet me nenin 116 ["Efekti Juridik i Vendimeve "] të Kushtetutës, bëhet fjalë për efektet e përgjithshme apo **erga omnes** të vendimeve të **Gjykatës Kushtetuese**, pa marrë parasysh nëse ato shërbejnë si burim formal juridik - kushtetues me rastin e vendosjes lidhur me një rast apo mosmarrëveshje konkrete. Thënë me fjalë të tjera, efekti **erga omnes** ka të bëjë edhe me individin, i cili asnjëherë nuk mund të jetë në pozitë për të përdorur **stare decisis:** detyrimi kushtetues sipas nenit 53 të Kushtetutës nuk i përshtatet personit të individit dhe vlen vetëm për subjektet kushtetuese që ushtrojnë autorizime publike në territorin e Kosovës.

Për efektet juridike të vendimeve të **Gjykatës Kushtetuese** flasim në kapitullin e 15-të në vijim. Fokusimi i diskutimit tonë këtu përqendrohet në teorinë dhe praktikën e **stare decisis** në **Kosovë**, kryesisht duke marrë si pikë referimi praktikën gjyqësore të **GJEDNJ**, e cila **per constitutionem** ka epërsi absolute kundër çdo praktike tjetër që ka të bëjë me liritë dhe të drejtat e njeriut. Kjo epërsi absolute, sikundër do të shihet në nënseksionet e seksionit të tretë, shihet më qartë dhe në mënyrë të dukshme në vendimmarrjen meritore të Gjykatës Kushtetuese, në ndërkohë që ky nuk është rasti me vendimmarrjet lidhur me masat e përkohshme dhe lejueshmërinë e kërkesës. Kjo qasje e shtjellimit të caqeve të **stare decisis** me origjinë nga **Strasburgu**, në gjyqësinë kushtetuese kosovare është bërë me qëllim të saktësimit të caqeve të tërësishme të zbatimit të nenin 53 si më sipër të Kushtetutës. U mor vesh, fokusi ngelet të përvojat e gjyqësisë kushtetuese kosovare, duke e lënë pjesën e gjyqësorit të rregullt dhe përvojat tjera të autoriteteve publike në dorën e dijetarëve të tjerë kompetentë në kohën që vjen.

13. 1. Kuptimi, lindja dhe zhvillimi i stare decisis

Fjalia latine **stare decisis et quieta non movere** shënon sintagmën që ne sot, në një formë të shkurtuar, e njohim vetëm si **stare decisis**. Ajo ka kuptimin "e lënies së gjërave ashtu siç janë vendosur, pa i trazuar pikat e zgjidhura njëherë."[1] Përmendet edhe në veprat letrare, te **Tregtari Venedikut** (1597) i **William Shekspeare**, ku personazhi me emrin **Portia** insiston në praktikën e respektimit të rreptë të detyrimit të krijuar financiar,[2] si dhe te **Udhëtimet e Guliverit** (1726) të autorit të njohur irlandez **Johnatan Swift.** Ky i fundit flet për këtë sintagmë si për një mbulesë të keqe që juristët anglezë e përdornin për të arsyetuar paudhësitë e tyre.[3]

Kaq për anën letrare të institutit **stare decisis**. Shtjellimi që pason mbulon diskutimin tonë për aspektet historike dhe krahasuese, gjithnjë të para nga këndi i kontekstit kosovar. Kjo bëhet me qëllim që të kuptohet esenca e institutit **stare decisis**, si një parim që nuk vlen vetëm në sistemin e të **drejtës së përgjithshme**, por edhe në sistemin e të drejtës civile, përfshirë këtu Kosovën. Në rastin e fundit, zbatimi i parimit **stare decisis** rrjedh si pasojë e natyrës së organizimit të gjyqësisë kushtetuese, përkatësisht si pasojë e rolit dhe pozitës juridike që kanë gjykatat kushtetuese në sistemin e të drejtës civile. Është fakt se në shumicën e zgjidhjeve kushtetuese në këtë sistem, ato kanë për detyrë primare mbrojtjen e lirive dhe të drejtave kushtetuese. Jo rrallë, gjykatat kushtetuese janë cilësuar si gjykata mbi të drejtat e njeriut, pikërisht për shkak se kanë marrë përsipër të shërbejnë si një mekanizëm juridik efektiv për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të garantuara kushtetuese.

Në këtë kapitull flasim, pikërisht për arsyet si më sipër, vetëm për **stare decisis** në kontekstin e gjyqësisë kushtetuese, përveç nëse në mënyrë shprehimore nuk e kemi bërë të qartë se ky nuk është rasti.

Ndër pyetjet themelore të **stare decisis** është ajo e caqeve të zbatimit të saj: a lidhet gjyqtari i ri vetëm për **ratio decidendi** apo edhe për ato pjesë të tjera të vendimit të mëhershëm që nuk kanë të bëjnë me thelbin e çështjes por për të cilat gjykata ka dhënë një prononcim? Këto të fundit ndryshe njihen si **obiter dicta**. Thënë ndryshe, cilat janë caqet materiale të detyrimit të gjyqtarit të ri që gjendet në pozitë për të zgjidhur apo vendosur një rast apo mosmarrëveshje të ngjashme apo identike me atë që është vendosur apo zgjidhur nga gjyqtarët tjerë në të kaluarën?

Që në fillim, në mënyrë apodiktike konstatojmë se vetëm **ratio decidendi** hyn në detyrimin e gjyqtarit, të cilin duhet ta ndjek me rastin e vendosjes apo zgjidhjes së rastit të ri.[4] Kjo është kështu sepse vetëm **ratio decidendi** na ndihmon për të kuptuar mënyrën se si funksionon e drejta e precedentit,[5] e cila nuk është pos një tërësi e parimeve dhe rregullave të pashkruara që shërbejnë si bazë juridike për vendosjen dhe arsyetimin e rasteve në të ardhmen. Të kuptuara si **ratio decidendi**, precedentët paraqiten në dy forma: nën një, precedentët që shërbejnë si model për vendosjen e rastit tjetër të ngjashëm apo të njëjtë në të ardhmen; dhe, nën dy, precedentët që shërbejnë si modele për vendosje lidhur me kuptimin e një fjale, fjalie apo me kuptimin e dispozitës juridike. Të parat cilësohen si **precedentë të zgjidhjes** (**precedents of solution**) kurse të dytat si **precedente të interpretimit** (**precedents of interpretation**).[6]

---

1 Cf. "Stare Decisis", në Henry Campbell Black, M.S. (ed.), *Black's Law Dictionary. Definitions of the Terms and Phrases of American and English Jurisprudence, Ancient and Modern* (West Publishing Co.: St. Paul, Minnesota, 1968), fq, 1577-1578.

2 William Shekspeare, *The Merchant of Venice* (Tale University Press: New Haven and London, 2006), Act IV, Scene I.

3 Jonathan Swift, *Gulliver's Travels* (Joe Books Ltd.: Toronto, 2016), Part IV, Chapter 5.

4 *Jan Komárek*, "Reasoning with Previous Decisions: Beyond the Doctrine of Precedent" *The American Journal of Comparative Law.* Vol. 61, No. 1 (Winter 2013), fq. 149-171 në fq. 151.

5 Thijmen Koopmans, "Stare Decisis in European Law". Në David O. O'Keeffe & Henry G. Schermers (eds.), *Essays in European Law and Integration: To Mark the Silver Jubilee of the Europa Institute, Leiden 1957-1982* (Kluwer – Deventer: The Netherlands, 1982), fq. 11-27 në fq. 24.

6 Bojan Spaić, "The Authority of Precedents in Civil Law Systems". *Studia Iuridica Lublinensia* Vol. XXVII No. 1 (2018) fq. 27-44 në fq. 30-32.

Në vijim, si më sipër, vetëm çështjet kushtetuese që kanë qenë objekt i vendimmarrjes meritore të gjykatave kushtetuese ngërthejnë dy llojet e precedentëve si më sipër, përkatësisht kanë të bëjnë në të njëjtën kohë me zgjidhjen dhe me interpretimin. Ky, ndërkaq, nuk mund të jetë rasti me vendimmarrjen që nuk prek meritat e rastit: **stare decisis** që nuk ka të bëjë me verdiktin përfundimtar lidhur me meritat e rastit nuk hyn në pjesën ligjërisht të detyrueshme për t'u respektuar me rastin e vendosjes së rasteve në të ardhmen. Vendimmarrja që ngërthen **stare decisis** dhe që ka të bëj me meritat e rastit ka natyrën e vendimit meritor (aktgjykimit), kurse kur nuk ka të bëj me meritat e rastit vendimi ka formën e aktvendimit. Rrethana që **stare decisis** nuk hyn në pjesën e ligjërisht të detyrueshme pos kur ka të bëjë me meritat e rastit konsiston në faktin se gjykatat, për arsye të ndryshme, mund të japin arsyetime shtesë, që nuk janë relevante për verdiktin përfundimtar, me qëllim të ushtrimit intelektual, për qëllime të edukimit të opinionit publik, si dhe për arritjen e shumë qëllimeve të tjera anësore. Në këto raste, qëllimet e synuara nga ana e gjykatave kushtetuese nuk kanë relevancë për dispozitivin e verdiktit gjyqësor.

Në Kosovë, i tillë ka qenë rasti i a. q. i **bartjes së shamive nëpër shkolla**: në këtë rast, **Gjykata Kushtetuese** pat vendosur që rasti nuk është i lejueshëm për shkak se kërkuesja nuk kishte shterur të gjitha mjetet efektive juridike dhe për arsye se rasti ka qenë qartazi i pabazuar.[7] Në pjesën e arsyetimit të vet, megjithatë, Gjykata ka dhënë disa mendime që në përgjithësi i referohen bartjes së shamive nëpër shkolla, si dhe mendime të tjera lidhur me rolin e religjionit në shoqërinë kosovare si dhe zgjidhjet kushtetuese ekzistuese në vend dhe në botë.[8] Të gjitha këto kanë qenë të bazuara në doktrinën e zhvilluar nga kjo gjykatë në mandatin e kryetarit të parë të saj, autorit të parë të librit, dhe njihet si doktrina **"sikur rasti të kishte qenë i pranueshëm"**. Sipas kësaj doktrine, Gjykata prononcohet lidhur me meritat e rastit që nuk ekziston dhe që është tërësisht hipotetik, përkatësisht kur rasti në të vërtetë ka qenë i palejueshëm për shqyrtim dhe gjykim si pasojë e mosshterjes së mjeteve juridike ose për shkaqe të tjera. Kjo doktrinë është krijuar me të vetmin qëllim që publikut kosovar t'i bartet një mesazh dhe t'i tregohet se si do të vendoste Gjykata potencialisht sikur rasti të ishte i lejueshëm për gjykim dhe vendosje. Arsyeja pse në këto raste **stare decisis** nuk kanë karakter detyrues është fare e dukshme dhe e thjeshtë: **Gjykata Kushtetuese** ndërton në imagjinatën e saj një situatë që nuk ekziston, pra një rast hipotetikisht të lejueshëm për gjykim dhe vendosje, me qëllim të edukimit të opinionit lidhur me verdiktin e saj në një situatë të tillë hipotetike. Në rastin e sipërcekur të shamive, Gjykata imagjinoi një situatë në të cilën rasti do të kishte qenë i lejueshëm duke parashikuar se verdikti i saj në një rast të tillë do të kishte qenë në favor të ndalimit të bartjes së shamive në arsimin parauniversitar në **Kosovë**. Kjo, megjithatë, nuk do të thotë se në praktikë mund të jetë kështu sepse jeta është më e pasur dhe se rrethanat faktike dhe juridike mund të çojnë në një verdikt krejtësisht të ndryshëm nga ai i imagjinuar nga Gjykata për një situatë hipotetike.

Gjykata ka përdorur këtë doktrinë në ato raste kur ka synuar që të luajë një rol edukativ në shoqërinë kosovare. Kjo nisur nga fakti se gjyqësia kushtetuese kosovare ka qenë diçka e re dhe fuqishëm ka imponuar nevojën që Gjykata, në të njëjtën kohë që merret me zgjidhjen e rasteve të paraqitura, të shërbejë edhe si një pikë referimi apo si një forum për edukim të publikut në sferën e të gjyqësisë kushtetuese. Kjo qasje nuk hyn në aktivizëm gjyqësor dhe as në precedent, përkatësisht në **stare decisis** që duhet ndjekur nga të tjerët me rastin e vendosjes në të ardhmen të rasteve dhe mosmarrëveshjeve të ngjashme apo identike. Kjo është kështu për dy arsye: e para, sepse arsyetimet e dhëna nga Gjykata kanë natyrën e prononcimeve gjyqësore **obiter dicta**, të cilat nuk i referohen meritave të rastit ngaqë **ratio decidenti** në këtë rast nuk ka të bëjë me meritat e rastit, por me lejueshmërinë e kërkesës; dhe, e dyta, sepse natyra e vendimeve që përmbajnë këto prononcime nuk i referohet vendimeve meritore por vendimeve lidhur me lejueshmërinë e rastit për gjykim dhe vendosje. Për llojet e vendimeve dhe natyrën e tyre juridike flasim më pastaj në kapitullin 15-të të këtij libri.

---

7 *Rasti KI 36/11. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Arjeta Halimi. Vlerësimi i kushtetutshmërisë të mos-përmbarimit të pretenduar të Aktgjykimit CN. nr. 24/09, të 17 nëntorit 2009, të Gjykatës së Qarkut në Gjilan dhe shkeljes së pretenduar të të drejtave të njeriut të parashtruesit të kërkesës.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtinë. Datë: 30 shtator 2011 . Nr. ref.: RK 137/11.

8 Ibid. paragrafët 76-78.

Mjafton të konstatojmë me këtë rast se arsyetimet e dhëna në një vendim jomeritor, cilado qoftë arsyeja e moslejueshmërisë së rastit për shqyrtim dhe gjykim, përfshirë këtu edhe arsyet që lidhen me pabazueshmërinë e qartë e kërkesës, çdoherë kanë natyrën e **obiter dicta**. Kjo nënkupton se në një rast tjetër gjyqtarët e rregullt dhe organet tjera nuk janë të detyruar të ndjekin precedentin e mëhershëm në rast se kërkesa e re për një arsye të caktuar paraqitet si e lejueshme për gjykim dhe vendosje dhe, për pasojë, prodhohet një vendim meritor (aktgjykim). Për të qenë një precedent i tillë i detyrueshëm për t'u ndjekur nga gjyqësori i rregullt dhe autoritetet tjera publike, ai duhet të ketë të bëjë me meritat reale të rastit apo mosmarrëveshjes konkrete.

Një aspekt tjetër me rëndësi i institutit **stare decisis**, që vjen pas kuptimit të elementit të **ratio decidenti**, ka të bëjë me pyetjen lidhur me funksionin që ka në një sistem juridik-kushtetues. Që në fillim shënojmë se nuk është vështirë të vërtetohet se funksioni primar ka të bëj me sigurinë juridike që prodhohet me vënien e tij në jetë. Ky institut paraqet një burim të rëndësishëm të së drejtës. Në këtë drejtim, në literaturë është vërejtur se sistemi i të drejtës civile prodhon më pak stabilitet dhe siguri juridike se sistemi i të **drejtës së përgjithshme**, në të cilin **stare decisis** paraqitet si burim formal i së drejtës. Kjo është kështu për shkak se, në rastin e sistemit të parë, praktika gjyqësore bazohet kryesisht në ligje të shkruara të cilat mund të ndërrojnë në çdo kohë, në ndërkohë që evoluimi i standardit të zbatueshëm të **stare decisis** në sistemin e të **drejtës së përgjithshme** është më i ngadalshëm por më stabil: në momentin e krijimit të tij gradual dhe të ngadalshëm, ka pak gjasa të ndodhë ndryshimi i tij i shpejt më pastaj. Për këtë duhet një kohë e gjatë, gjë që nënkupton se ai ndryshim bëhet në mënyrë krejtësisht evolutive. Në dy rastet, megjithatë, **stare decisis** shërben si burim i së drejtës: në të parim, në kuptimin formal i sanksionuar përmes normave juridike, në të dytin si burim **de facto** bazuar në praktikën e kaluar gjyqësore.

Në vijim si më sipër, pjesë përbërëse e sigurisë juridike që prodhohet nga zbatimi i **stare decisis** është funksioni tjetër me rëndësi që buron si pasojë e vetë sigurisë. Ai ka të bëjë me ofrimin e drejtësisë aty ku ka zbrazëti juridike apo ku ligji nuk është i qartë sa duhet. Po të mos ishte instituti i **stare decisis**, zbatimi i të cilit rezulton në mbushjen e zbrazëtive juridike apo ligjore në pjesët ku norma nuk është e qartë sa duhet, atëherë gjykatat do të viheshin në pozitën e mohuesit të drejtësisë (***déni de justice***). Një situatë e tillë nënkupton që **stare decisis** shërben si një institut i fuqishëm që i lejon gjykatat të ofrojnë drejtësi edhe atëherë kur ekzistojnë zbrazëti juridike apo kur norma juridike që duhet të zbatohet nuk është e qartë, gjithnjë me qëllim primar që subjektit të së drejtës mos t'i mohohet dhënia e drejtësisë. Kjo është një ndër arsyet që zbatimi i **stare decisis** i venë gjyqtarët e dy sistemeve juridike para dilemës thelbësore, e cila shprehet me terma të ndryshme. Në rastin e sistemit të së **drejtës së përgjithshme** ajo dilemë sillet rreth ndjekjes ose jo të urdhrave të asaj që në literaturë është cilësuar si **perandori e praktikës gjyqësore mekanike (Empire of Mehcanical Jurisprudence)** kurse në sistemin e të drejtës civile dilema sillet rreth zbatimit ose jo të asaj që cilësohet si **praktikë gjyqësore arbitrare** (**Empire of Arbitrary Jurisprudence**).[9]

Në rastin e parë, gjyqtarët ngelin robër të precedentëve të mëhershme, të cilat në praktikë zakonisht i përdorin në mënyrë mekanike dhe pa ndonjë vlerësim kritik. Edhe atëherë kur shohin qartas së vendimi i mëhershëm është i padrejtë (kjo sepse në aspektin formal, **stare decisis** në këto vende përbën një burim formal të së drejtës, i detyrueshëm për t'u zbatuar) Në rastin e dytë, ndërkaq, gjyqtarët ndjekin në mënyrë dogmatike germën dhe frymën e ligjit, pa marrë parasysh vendimmarrjen e mëhershme, duke u mbështetur në precedentë të mëhershme sipas tekeve të rastit pa asnjë frikë se po shkelin standardet ligjore mbi burimet e së drejtës (ku **stare decisis** nuk bën pjesë, në aspektin formal, në burimet e së drejtës, por vetëm si burim **de facto** që përdoret sipas dëshirës së gjyqtarit).

---

[9] Këto shprehje janë përdorur për herë të parë nga **Z. Kuhn** në një shkrimin të tij për të përshkruar rreziqet potenciale që ekzistojnë në mënyrë të njëjtë në dy sistemet - në sistemin e të **drejtës së precedentëve** (sistemi i të **drejtës së përgjithshme**) dhe sistemi i të **drejtës së shkruar** (**sistemi civil)**. Cf. më shumë për këtë në Frank Emmert, "Stare Decisis: A Universally Misunderstood Idea" *Legisprudence* Vol. 6 No. 2 (2012) fq. 207-227, fusnota nr. 2 (në fakt, tërë shkrimi i këtij autori sqaron se konceptualisht, por edhe në pasoja praktike nuk ka ndonjë dallim të madh në mes dy sistemeve, nisur nga fakti se edhe vendet e sistemit të së **drejtës së përgjithshme** janë zhytur në një aktivitet të dendur legjislativ si pasojë e dominimit të pozitivizmit në të drejtën e brendshme dhe në të drejtën ndërkombëtare, në veçanti kur bëhet fjalë për liritë dhe të drejtat e njeriut dhe integrimet regjionale evropiane.

Krahas funksioneve si më sipër, në themel të origjinës moderne të këtij instituti janë vërejtur edhe disa funksione të tjera të rëndësishme që ka luajtur përgjatë historisë. Ndër to bëjnë pjesë, ta zëmë, sigurimi i një gjykimi të drejtë dhe i paanshëm, ngritja e besimit në drejtësi, e*fiçenca* dhe konsistenca në ushtrimin e drejtësisë, parashikueshmëria dhe ekonomizimi në administrimin e drejtësisë etj, etj.[10] Në literaturë besohet se këto funksione nuk kanë mundur të arrihen, historikisht shikuar, nga instituti i kodifikimit në sistemin civil të së drejtës që bazohet vetëm në norma të shkruara juridike si burime kryesore dhe të vetme të së drejtës.[11] Kjo, megjithatë, dallon kur bëhet fjalë për gjyqësinë kushtetuese të sistemit civil, e cila funksionon krejtësisht ndryshe nga gjyqësia e rregullt: fizionomia dhe roli e pozita e kësaj gjyqësie ka një mision tjetër që e dallon nga gjyqësori i rregullt. Ky dallim nuk ekziston në sistemin e të **drejtës së përgjithshme**, ku roli dhe rëndësia që ka precedenti është i njëjtë për të gjitha llojet e gjyqësisë, asaj kushtetuese dhe gjyqësisë së rregullt. Në këtë sistem, precedenti gjyqësor i ndërtuar interpretohet me referim kuptimeve të tij në të kaluarën për qëllim të zbatimit në një rast apo mosmarrëveshje tjetër reale dhe konkrete, gjithnjë duke u mbështetur në modelin e interpretimit ashtu siç është zbatuar një herë tjetër në të kaluarën. Në sistemin civil, ndërkaq, fjala është për interpretimin e një norme juridike (ligjore, kushtetuese apo tjetër) ashtu siç është vepruar në një vendim të mëhershëm. Në rastin e fundit, në sistemin civil të së drejtës, **sillogjizmi gjyqësor** ka të bëjë me përshtatjen e normës juridike një gjendje faktike, kurse në rastin e parë, në sistemin e të **drejtës së përgjithshme**, **silogjizmi gjyqësor** ka të bëjë me nënvënien e një rasti aktual faktik dhe juridik një rasti tjetër real të vendosur më herët me një vendim gjyqësor të formës së prerë.

Gjendja ndryshon kur ekziston një kushtetutë e shkruar dhe kur bëhet fjalë për çështjet kushtetuese. Kur ekziston një kushtetutë e shkruar si burim i së drejtës, pa marrë parasysh nëse është sistem civil apo i përgjithshëm i së drejtës, ndryshimi i precedentit konsiderohet si legjitim me supozim se është i arsyetuar mirë dhe ka bazë parimore. Pse kjo konsiderohet kësisoj? Kjo është kështu sepse, në fund të fundit, ajo që ngelet, është vetë teksti i kushtetutës, i dispozitës që interpretohet. Ai interpretim ngelet prerogativë e vetë interpretuesit. Thënë me fjalë të tjera, në dy sistemet e së drejtës, mbështetja në **stare decisis** ndryshon. Ajo mbështetje nuk konsiderohet se është e plotë nëse ekziston një kushtetutë e shkruar e, megjithatë, vendoset apo zgjidhet një çështje kushtetuese me mbështetje në një precedent të së kaluarës. Për të qenë e plotë mbështetja në **stare decisis** në një vend me kushtetutë të shkruar, atëherë duhet të plotësohen dy kushte. Plotësimi i tyre është kumulativ për shkak se, **stare decisis** në vendet që kanë kushtetutë të shkruar, pa marrë parasysh sistemin e së drejtës, ndiqet nga gjyqtarët e mëvonshëm vetëm në kuadër të dispozitave kushtetuese dhe vetëm në kontekst të vendosjes lidhur me një çështje apo mosmarrëveshje kushtetuese. I tillë është rasti, ta zëmë, me **SHBA**, **Afrikën e Jugut** dhe vendet tjera që i takojnë sistemit të së **drejtës së përgjithshme**, por që kanë një kushtetutë të shkruar.

Në vijim të diskutimit si më sipër, në sistemin e të drejtësisë së përgjithshme ku ekziston një kushtetutë e shkruar, precedenti ka më pak fuqi juridike se teksti i kushtetutës, ashtu që edhe ndryshimi i tij çdoherë mund të arsyetohet me ruajtjen e germës (tekstit) dhe frymës së kushtetutës. Shikuar historikisht, kështu në të vërtetë ka lindur instituti i kontrollit gjyqësor në rastin **Marbury vs Madison** (1803), pra, si pasojë e ekzistimit të një kushtetute të shkruar, e cila, siç e ka konstatuar vetë Xhon Marshall (**John Marshall: 1755-1835)**, kryetari Gjykatës Supreme në atë kohë, ka nevojë të jetë çdoherë ligji suprem në vend. Çdoherë kur një ligj bie ndesh me normën më të lartë në vend, gjyqësori

---

[10] James C. Rehnquist, "The Power that Shall be Vested in a Precedent: Stare Decisis, the Constitution and the Supreme Court" *Boston University Law Review* Vol. 66 Nos. 3-4 (May-July 1986), fq. 345- 376 në fq. 347-348;
Vincy Fon & Francesco Parisi, "Judicial precedents in civil law systems: A dynamic analysis". *International Review of Law and Economics* Vol. 26 Issue 4 (2006) fq. 519–535 në fq. 522; Stephen Waddams, "Review: Authority, Precedent, and Principle". *The University of Toronto Law Journal*, Vol. 59, No. 1 (Winter, 2009), fq. 127-133 në fq. 129.

[11] Vincy Fon & Francesco Parisi, "Judicial precedents in civil law systems: A dynamic analysis", fq. 522.

duhet të tregojë se kushtetuta mbizotëron, jo anasjelltas.[12] Në traditën amerikane çdoherë është bërë dhe bëhet dallimi në mes të kushtetutës dhe interpretimit kushtetues, diçka që shpjegon edhe efektin **inter partes** të vendimeve gjyqësore që nga koha e themelimit të mekanizmit institucional të kontrollit kushtetues të ligjeve. Arsyetimin për këtë e ka dhënë **Xhon Marshall**, me rastin e nxjerrjes së vendimit të sipërcekur në rastin **Marbury vs. Madison**: esenca e arsyetimit ka qenë sigurimi i supremacisë së kushtetutës përmes interpretimit, diçka që nuk kishte qenë shprehimisht e parashikuar në dispozitat kushtetuese.[13]

Përveç në **SHBA** dhe **Afrikën e Jugut**, i njëjte është rasti edhe në **Irlandë** dhe në praktikën e saj gjyqësore.[14] Mospasja e një kushtetute të shkruar, në të njëjtën kohë shpjegon pse me rastin Dr. **Bonham** (1610) nuk ka nisur asnjëherë ndërtimi i institutit të kontrollit të kushtetutshmërisë: në **Angli** kushtetutë të shkuar nuk ka pasur as atëherë dhe as sot dhe, për pasojë, nuk ka pasur nevojë që të vijë deri te sigurimi i supremacisë (epërsisë) së asaj që nuk ekziston. Kjo situatë, në fakt, vjen si pasojë e ekzistimit të një supremacie (epërsie) tjetër - supremacisë (epërsisë) së parlamentit.

T'i kthehemi tani çështjes së lindjes dhe zhvillimit të institutit të **stare decisis**.

Origjina e **stare decisis**, njëjtë si origjina e shumë instituteve tjera të së drejtës moderne, lidhet me të drejtën romake: në literaturë është vërejtur se shenjat e para rudimentare të tij kanë ekzistuar qysh para erës sonë, të mishëruara në të a.q. **ius praetorium** apo **ius honorarium**. Pretorët, që kishin zëvendësuar **pontifices**, përmes interpretimit të tyre të gjerë të **ius civile** kujdeseshin për aplikimin, përmirësimin dhe plotësimin e rendit ekzistues juridik romak. Këtë ata e bënin me **edikte** apo **urdhra**, me ndihmën e të cilëve ia përshtatnin kushteve konkrete jetësore tërë rendin juridik romak të **ius civile.**[15] Përmes tyre, pretorët romak ndanin drejtësi: ato kishin natyrën e parimeve që çdo vit i shpallte secili magjistrat (zyrtar) i ri romak që merrte detyrën e pretorit. Ediktet dallonin nga ligjet e zakonshme (**leges**) për shkak se nxjerrja e tyre në tërësi ishte në diskrecion të vetë pretorit.[16] Kjo gjendje ndryshoi në vitin 131 kur u nxor **edictum perpetum**, një kodifikim i bërë me urdhër të perandorit **Hadrian**: tani e tutje pretorët ishin të detyruar të respektonin në tërësi ediktet e pretorëve pararendës, gjë që nuk kishte qenë rasti më herët kur pretorët e rinj mund të nisnin çdo vit të punës së tyre te re me publikimin e edikteve të tyre të reja, me rastin e dhënies së drejtësisë qytetarëve romakë.[17] Në këtë kuptim mund të thuhet që ky hap i perandorit **Hadrian** i dha **ediktit** forcën e ligjit unik të kodifikuar, që ngjason me ligjin si burim i së dre-

---

12 James C. Rehnquist, "The Power that Shall be Vested in a Precedent: Stare Decisis, the Constitution and the Supreme Court", fq. 365-367 (ku autori shtjellon tezën shumë të qëlluar sipas së cilës normat e kushtetutës, në instancë të fundit, ndryshohen vetëm me norma të natyrës së njëjtë, në ndërkohë që interpretimi kushtetues i normës kushtetuese çdoherë ka një fuqi më të ultë se vetë norma kushtetuese që interpretohet).

13 Henry Paul Monaghan, "Stare Decisis and Constitutional Adjudication". *Columbia Law Review* Vol. 88 No. 4 (May, 1988), fq. 723-773 në fq. 767-772.

14 Thijmen Koopmans, "Stare Decisis in European Law", fq. 14.

15 Ivo Puhan, *E drejta romake* (Universiteti i Prishtinës: Prishtinë, 1976) fq. 52.

16 Cf. Alan Watson, "The Development of the Praetor's Edict". *The Journal of Roman Studies* Vol. 60 Issue 1 (November 1970), fq. 105-119 (ku autori ndjek origjinën e formimit të edikteve pretoriane, duke konstatuar se viti 100 p.e.s. duhet të jetë si pikënisje, ani se edikti i parë daton nga v. 213 p.e.s, thotë autori; dallimin në mes të edikteve si aktivitetet ligjvënës i pretorëve romak dhe akteve të tjera procedurale dhe faktike të **Romës** republikane, autori e gjen në atë se ediktet kanë pasur fuqinë për të ndryshuar të drejtën materiale, në ndërkohë që aktet tjera kishin të bënin me aspektet faktike dhe procedurale të rastit konkret; para vitit 125, **leges** ka qenë forma kryesore e aktivitetit ligjvënës në **Romë** dhe mënyra kryesore e reformimit të **ius civile**; pas këtij viti, **edictum** ka qenë forma kryesore deri në themelimin e **Perandorisë Romake**; pas themelimit, aty rreth vitit 131, nis ndërprerja me të kaluarën, viti kur u nxor **edikti i Hdrianit (edictum perepetum)**; në fund, autori konstaton se në **Romë**, gjatë tërë kohës ka qenë i paqartë raporti në mes të **leges** dhe **edictum**; kjo rrethanë duket se ka qenë përcaktuese për nxjerrjen e **edictum perepetum**, me qëllim të evitimit të paqartësive në aktivitetin normavënës të zyrtarëve romak).

17 Cf. P.E. Corbett, M. A., "The Legislation of Hadrian" *University of Pennsylvania Law Review* Vol.; 75 No. 8 (June 1926), fq. 753-766 në. fq. 755; Adolf Berger, *Encyclopedic Dictionary of Roman Law*, Volume 43, Part 2 (American Philosophical Society: Philadelphia, 1951) fq. 549; "Lex Corenlia de jurisdictione / Lex Cornelia de edictis", në Bryan A. Garner (ed.), *Black's Law Dictionary,* 9th Ed. (West Publishing, Inc.: St. Paul, Minnesota, 2009), fq. 993.

jtës në kuptimin modern të fjalës.[18] Mbase kjo është arsyeja që **edictum perepetum** merret, nga disa autorë të huaj, si një shembull i parë i kodifikimit në botën juridike perëndimore.[19]

Sa i përket **stare decisis**, ndërkaq, e tërë situata e përshkruar si më sipër nuk ka pasur ndonjë relevancë: as **ediktet** apo **urdhrat pretoriane**, por as **edictum perepetum** i perandorit **Hadrian** nuk kanë pasur një cilësi apo efekt të tillë. Kjo është kështu për faktin se nuk ka qenë fjala për vendimet përfundimtare gjyqësore dhe përligjësimin e tyre për të ardhmen, por ekskluzivisht për interpretim përmes edikteve apo urdhrave të së drejtës romake, **ius civile**, me qëllim të arritjes së një rezultati të drejtë dhe të ndershëm për qytetarët romak në rastet konkrete dhe specifike. Ky rezultat në shqip emërtohet si **ekite** (angl. **equity**), për shkak se bazohet në parimet e shpallura abstrakte të pretorëve romak, sipas diskrecionit të tyre. Ato kanë ndryshuar nga një rast në tjetrin, deri në nxjerrjen e **edictum perepetum** ku ka filluar respektimi i edikteve të mëhershme.

Ajo që do të ngjasojë me **stare decisis** në kuptimin modern, pra që ka kuptimin e pasjes për objekt interpretimi vendimet e mëhershme përfundimtare gjyqësore dhe trajtimin e tyre si ligje për vendimmarrjet në të ardhmen, ka lindur shumë më vonë dhe i referohet llojit të aktivitetit perandorak të vendimmarrjes. Sikundër e thotë juristi i njohur romak **Ulpiani**, perandori ka qenë ligji vetë: vendosja nga ai në instancë të fundit ka shërbyer si një precedent për gjithë të tjerët. Kjo fuqi detyruese e ngjashme me **stare decisis** nuk buronte nga fakti se vendimi i mëhershëm perandorak kishte forcën e ligjit, siç është sot rasti me **stare decisis**, por për shkak se vendimi, pa marrë parasysh përmbajtjen e tij, ka qenë vendim perandorak.[20] Ka qenë e ndaluar në mënyrë të rreptë komentimi i vendimeve të perandorit. Këtu, megjithatë, sërish nuk mund të flitet për **stare decisis** në kuptimin modern të fjalës: fuqia e ligjit e vendimit të mëhershëm perandorak merrej si e mirëqenë nga gjyqtarët e mëvonshëm, pa pasur nevojë që më tutje të përpunohet përmbajtja e tij. Në këtë kohë, vlen të theksohet, as që bëhej fjalë për publikimin e rasteve të vendosura më herët, qoftë edhe nga vetë perandorët kur vepronin si gjyqtarë, me qëllim të citimit të tyre më pas. Shumë më vonë, diku deri në vitin 300 të erës sonë, një cilësi e tillë iu njoh vetëm mendimeve të juristëve, të njohura si **ius respondenti**, botimet e të cilëve u përmblodhën nëpër traktate të veçanta që vlenin si tekste të detyrueshme për gjyqtarët.

---

[18] Ediktet kanë qenë si burime të së drejtës shumë më të ndryshme nga aktet e perandorit, si zyrtari më i lartë në vend. Këto të fundit njiheshin me emrin **constitutiones** dhe kishin efekt **erga omnes**, u mor vesh përveç atyre që kishin natyrë personale dhe që vlenin për persona konkret . Cf. Barthold Georg Niebuhr, *The History of Rome. Volume Third* (Lea & Blanchard, 1844) fq. 127; P.E. Corbett, M. A., "The Legislation of Hadrian", fq. 754 (ku autori vjen te konstatimi i njëjët sa i përket natyrës juridike të **constitutiones**, të cilat më pastaj në tërë shkrimin i shtjellon me fokus kryesisht në fushën e të drejtës private romake, e shumë më pak në fushën penale); Gian Biagio Conte, *Latin Literature: A History* (The Johns Hopkins University Press: London and Baltimore, 1994), pjesa e 4-të që flet për literaturën juridike dhe sistematizimin e doktrinës, fq. 584-588; Rendall Lesaffer, *European Legal History. A cultural and Political Perspective* (Cambridge University Press: Cambridge, 2011), fq. 102.

[19] Kaius Tuori, "Hadrian's Perpetual Edict: Ancient Sources and Modern Ideals in the Making of a Historical Tradition." *The Journal of Legal History* Volume 27 Issue 3 (December 2006), fq. 219-237 (autori shpjegon tri teori lidhur me natyrën juridike dhe qëllimin historik të ediktit të **Hadrianit**: teoria e legjendës post-klasike; teoria e kompilacionit eklektik dhe teoria e kodifikimit; në fund, pas analizës së gjatë, autori vjen në përfundim dhe thekson se edikti në fjalë ka qenë pararendës i **Corpus Iuris Civil**, si një përmbledhje eklektike jo kritike e pjesëve më të përzgjedhura të së drejtës romake, bazuar në tekstin e thjeshtë, pa asnjë kodifikim sistematik dhe racional të materies siç bëhet sot me metoda të shkencës juridike; në kohën e nxjerrjes së tij, sipas autorit, edikti **Hadrianit** ka qenë efekt refleksiv i centralizimit të pushtetit dhe rritjes së pushtetit imperial, që ka shërbyer për arritjen e dy qëllimeve: e para, reduktimin e dukshëm të pushtetit të pretorëve të kohës së **Romës** republikane; dhe, e dyta, perandori më te ka arritur monopolizimin e pushtetit ligjvënës).

[20] Cf. më shumë në G. A. Harre, "Precedent in Roman Law" *Studies in Philology* Vol. 19, No. 1 (January, 1922), fq. 52-63 në fq. 54-55; *The Digest of Justinian*, Vol. I, translated by Charles Henry Monroe, M.A. (Camridge at the University Press: Cambridge 1904) (kapitulli i 4-të, "Enactments by Emperors", ku jepet kuptimi i edikteve perandorake sipas sqarimeve të dhëna nga **Ulpiani**); *GAI Institvtiones or Institutes of Roman Law by Gaius*, with a translation and commentary by the late Edward Poste, M.S. (Oxford at the Clarendon Press: Oxford, 1904), paragrafi i dytë i librit të parë, kapitulli që flet për të drejtën civile dhe natyrore dhe për burimet e së drejtës romake.

Në fakt, pas këtij viti, disa perandorë romakë i kodifikuan ato: në vitin 426, perandori **Valentinian** III shkoi aq larg sa krijoi të drejtën e citimeve për veprat e juristëve të njohur romakë si **Gaius**, **Papinian**, **Ulpian**, **Paulus** dhe **Modestinus**. Kjo nënkuptonte se tani e tutje shkenca juridike e përpunuar dhe e predikuar nga këta jurist romakë do të shërbente si burim i së drejtës për magjistratët romakë që ndanin drejtësi. Kjo qasje kulmoi me publikimin gjatë viteve 529-534 të përmbledhjes së mirënjohur juridike të perandorit **Justiniani** I-rë, e njohur ndryshe si **Corpus Iuris Civilis.**[21] Më këtë publikim u bë e qartë se mendimet dhe shtjellimet e juristëve romakë në të kaluarën, të cilat ishin përmbledhur në **Digesta** dhe në **Institutiones,** përbënin një detyrim për gjyqtarët dhe tjerët që ndanin drejtësi. Pra, këtu bëhet fjalë për shkencën juridike, jo për vendimet e mëhershme si burim i së drejtës: vendimet e mëhershme asnjëherë në të drejtën romake nuk kanë pasur një fuqi të tillë. Kjo nënkupton se në kohën e **Justinianit** I, gjyqtarët përfundimisht qenë të kufizuar në vendimmarrje nga shtjellimet dhe mendimet e juristëve romakë të sipër cekur të cilët ishin cituar në **Digesta** dhe nga ribotimet e pjesëve të caktuara të akteve perandorake të **Codex**-it, në një mënyrë afërsisht të njëjtë siç kishte qenë rasti deri pas vitit 300, por asnjëherë nga vendimet e mëparshme gjyqësore të magjistratëve romakë.[22]

Periudha **e Mesjetës** e deri te pozitivizmi i shekullit XVIII ka dy momente të rëndësishme në lidhje me institutin **stare decisis,** të cilat e meritojnë vëmendjen tonë. I pari moment ka pasur të bëjë me kontradiktën e dy fjalive të **Corpus Iuris Civilis**, të thëna nga glosatorët dhe komentuesit e të drejtës romake gjatë kohë së **Renesansës**. Në ndërkohë që sipas **Codex** përparësi ka e drejta e shkruar në formë të ligjeve, në **Digesta** situata paraqitet e kundërt sepse përparësia kalon në favor të respektimit të precedentëve të mëparshëm, të përfolura dhe përpunuara nga juristët romakë të kohës. Më vonë, glosatorët krijuan teorinë e tyre mbi të drejtën zakonore, duke e cilësuar të tillë çdo situatë ku vendimet janë të njëjta për një kohë të gjatë. Respektimi i zakoneve apo i vendimeve që janë të njëjta për një kohë të gjatë, megjithatë, në **Mesjetë** nuk ka pasur kuptimin e një detyrimi formal, pa marrë parasysh se gjykatat në vazhdimësi kanë pasur respekt të madh për to. Jo rrallë, gjykatat kanë përqafuar gjetjet e vendimeve të mëhershme në rastet e paraqitura për vendosje apo zgjidhje pranë tyre.[23] Ky zbatim i precedentit bëhej në kuadër të interpretimit të parimeve dhe normave të së drejtës romake të receptuar, zbatim që qenë i dukshëm në veçanti në **Francë** e **Gjermani** përgjatë shekujve XV dhe XVI. Në këtë kohë ka nisur botimi i përmbledhjeve të vendimeve të gjykatave më të larta në vend. E drejta romake konsiderohej si një sistem komplet ashtu që nga gjyqtarët kërkohej që, përmes interpretimit, të gjenin rregullën adekuate. Kjo teknikë u cilësua si **jurisprudenca e koncepcioneve** apo **metoda e konstruktimit**. Një gjendje si kjo ka vazhduar deri në lindjen e shkollës historike dhe pozitivizmit, që e shihnin burimin e së drejtës jo në fuqinë e gjykatave dhe në interpretimet gjyqësore, por në vullnetin e popul-

---

21 G. A. Harre, "Precedent in Roman Law", fq. 60-61.

22 Ibid. fq. 61-63; Në literaturën mbi historinë e të drejtës romake ende sot diskutohet për atë nëse të a.q **response** dhe veprat tjera të juristëve romak kanë qenë paraqitje besnike e konjukturave politike të pushtetit të kohës apo kanë ngërthyer në vete një analizë kritike dhe një perspektivë kreative lidhur me fenomenet juridike të **Romës**. Mendim i përgjithshëm është se veprat e juristëve romakë në **Digesta** dhe **Institutiones**, por edhe tekstet juridike të magjistarëve dhe perandorëve romak kanë qenë fuqishëm të ndikuar nga juristët romak, në veçanti pas nxjerrjes së **edictum perpetum**, kur pretorët u zëvendësuan në masën më të madhe nga juristët. Cf. më shumë për këtë në shkrimin e shkëlqyer të autorit Alan Roger, "Behind the Scenes of Roman Law". *Oxford Journal of Legal Studies* Vol. 3, No. 3 (Winter, 1983), fq. 382-404 (ku autori bën analizën e thellë krahasuese të tri veprave të historianit të njohur të së drejtës romake **Tony Honore** lidhur me procesin e kodifikimit të së drejtës romake nga **Iusitinian** i I-rë; **Toni Honore**, në tri veprat që analizohen, bën një shkëputje nga tradita gjermane e nisur me **Savigny**, sipas të cilit juristët romakë kanë qenë tërësisht rigjid, jo kritik dhe përshkrues të teksteve zyrtare juridike pa asnjë ndikim në to; autori sqaron se në këto tri vepra, **Toni Honore** dhe disa autorë tjerë, të cilët analizohen në këtë shkrim, kanë ndjekur një traditë tjetër nga ajo e **Savigny**-t, duke u njohur juristëve romak një rëndësi kolosale në përcaktimin e përmbajtjeve të teksteve juridike romake).

23 Stefan Vogenauer, "Precedent, rule of". Në Jurgen Basedow, Klaus J. Hopt, Reinhard Zimmermann, and Andreas Stier (eds.), *The Max Planck Encyclopedia of European Private Law* (Oxford University Press: Oxford, 2012) fq. 1305.

lit.[24] Kjo zëvendësoi pikëpamjet e mëhershme të juristit gjerman **Savinji (Friedrich Ludvig von Savigny: 1779-1861)**, përfaqësuesi më i denjë i shkollës historisë të drejtësisë, sipas të cilit drejta nuk është asgjë tjetër pos shprehje e shpirtit nacional dhe e kulturës së një populli. Kjo nënkuptonte, për dallim nga pikëpamjet franceze të shek. XVIII, se e drejta nuk mund të imponohej nga jashtë sepse nuk mund të përshtatej me shpirtin nacional dhe kulturën vendore.

U mor vesh, krejt kjo si më sipër ka të bëj me sistemin civil evropian. Në **Angli** u zhvillua një kulturë tjetër juridike sa i përket rolit dhe pozitës së precedentëve gjyqësor në sistemin juridik dhe kushtetues të këtij vendi. Këtë e sqarojmë në vijim. Tani t'i kthehemi momentit të dytë si më sipër, lindjes së **pozitivizmit** dhe pasojave të tij në sferën e precedentit.

Nisja e pozitivizmit në **Evropë** në shekullin XVIII ka bërë të pamundur diskutimin rreth ekzistimit të kulturës së mëhershme të respektimit të precedentëve. Kjo është e kuptueshme për dy arsye: e para, sepse gjyqtarët e **ancien regime** ishin kompromet uar deri në palcë, aq shumë sa konsideroheshin vetëm si një **bouche de la loi** (goja e ligjit), pa asnjë të drejtë për interpretim të ligjeve ekzistuese. Kjo nënkupton se precedentët e mëparshme nuk mund të shërbenin si burim i të drejtës sepse ishin dhënë nga një profesion që tanimë konsiderohej i kompromet uar gjatë kohës së **ancien regime**, njëjtë siç kishte qenë rasti me pretorët romakë të kohës para nxjerrjes së **edictum perepetum**. Ndalesa e përdorimit të precedentëve, në disa vende, si p.sh. në **Austri,**[25] **Francë,**[26] **Gjermani**[27] etj., u sanksionua me ligj në mënyrë shprehimore. Ky ndalim ligjor kishte të bënte si me interpretimin e ligjeve aktuale ashtu edhe me interpretimin e atyre të vjetra që kishin shërbyer si bazë për krijimin e precedentëve në të kaluarën. Një gjendje e tillë ka mbizotëruar, pak a shumë, në të gjitha vendet që i takuan sistemit civil të së drejtës, ku precedentët nuk mund të shërbenin më si burim formal i së drejtës. Ato mund të shërbenin vetëm si një argument joformal shtesë për formimin e bindjes së gjyqtarit me rastin e vendosjes së një rasti.[28]

Në vijim, si më sipër, kjo rrethanë paraqet arsyen e dytë që shpjegon prishjen e kulturës juridike, e cila dikur **de facto** kishte respektuar precedentin si burim të së drejtës, arsye që ka të bëjë me lindjen e **kodifikimit** dhe **ligjvënies konstante**, këtyre dy produkteve më emblematike të pozitivizmit evropian. Aktiviteti i kodifikimit dhe ligjvënies sistemike filloi me kodifikimet e **Napoleonit** dhe më pas mori hov nëpër vendet tjera të **Evropës** kontinentale në gjysmën e parë të shek. XIX dhe tutje.[29] Kjo bëri që në gjyqtarë të ngelte vetëm detyrimi i zbatimit të asaj që ishte kodifikuar. Lëmenjtë kryesorë të së drejtës u kodifikuan për një kohë të shkurtër. Kodifikimi, pra, shërbeu si arsyeja e dytë për rrënimin e kulturës ekzistuese juridike që **de facto** respektonte precedentët e mëparshëm, ani se ligjërisht një gjë e tillë nuk përbënte detyrim ligjor sepse precedentët nuk paraqisnin burim formal të së drejtës.

Kjo situatë ndryshoi në mesin e shekullit XIX. Kjo kohë paraqet momentin kur në **Evropën** kontinentale sërish fillon të vihet në spikamë dobia e përdorimit **de facto** të precedentit si metodë për reduktimin e pasigurisë juridike dhe ngritjen e standardeve të përgjithshme të interpretimit të ligjeve ekzistuese, në

---

24 D. K. Lipstein, "The Doctrine of Precedent in Continental Law with Special Reference to French and German Law", *Journal of Comparative Legislation and International Law*, Vol. 28, No. 3/4 (1946), fq. 34-44 në fq. 40-41.

25 Charles Soule, "Stare Decisis in Continnetal Europe". *Green Bag* Vol. 19 (1907) fq. 460-461; D. K. Lipstein, "The Doctrine of Precedent in Continental Law with Special Reference to French and German Law", fq. 38 (në **Austri** me ligjin e vitit 1872 u ndalua në mënyrë shprehimore përdorimi i **stare decisis**).

26 Ernst J. Cohn, "Precedents in Continental Law". *The Cambridge Law Journal*. Volume 5, Issue 3 **(**November 1935) fq. 366-370; Frank Emmert, "Stare Decisis: A Universally Misunderstood Idea", fusnotat nr. 7 & 21 si dhe teksti që e shoqëron në fq. 6-7 & 214; Vincy Fon & Francesco Parisi, "Judicial precedents in civil law systems: A dynamic analysis", fq. 522, fusnotat 7 & 8.

27 D. K. Lipstein, "The Doctrine of Precedent in Continental Law with Special Reference to French and German Law", fq. 38 (autori thekson se, megjithatë, mbledhja e përbashkët e të gjitha dhomave të Gjykatës Supreme të Prusisë, **Reichtgericht**, mund të ndryshonte praktikën e deriatëhershme të njërit prej divizioneve të veta; kjo, megjithatë, nuk i detyronte gjykatat e ulëta por vetëm divizionin respektiv të **Reichtgericht**; disa shtete, si **Bavaraia** dhe **Hanoveri** kishin rregulla ligjore që lejonin **stare decisis**).

28 Ibid., fq. 34-44.

29 Ibid., fq. 35-36.

ndërkohë që në aspektin formal nuk pranohej si burim i së drejtës. Ky shikim dashamirës ndaj precedentit vinte si pasojë e faktit se kishin kaluar dekada të tëra nga **Revolucioni Francez** dhe ishte harruar logjika juridike e besimit të verbër në kode dhe ligje të veçanta, përkatësisht ishte harruar ndalimi ligjor i kreativitetit gjyqësor dhe mbështetja dogmatike në kod dhe në ligj.[30]

Në studime empirike përmendet se si në fillim të shekullit XX në **Evropën** kontinentale praktika e respektimit **de facto** të precedentit si burim i së drejtës kishte zënë rrënjë të thellë, në ndërkohë që ligjet e kodifikuara akoma ruanin qëndrimin e kundërt lidhur me precedentët si burime të së drejtës.[31] Këtu, megjithatë, nuk bëhej fjalë për burim **de facto** të së drejtës por për precedentin si një inspirim. Përdorimi i tij në sistemin civil përdoret në mënyrë më fleksibile se në sistemin e të **drejtës së përgjithshme**: roli i tij reduktohet në inspirim, asgjë më shumë. Kjo gjendje në thelb nuk ka ndryshuar as sot e kësaj dite, me përjashtim të vendeve **ish-komuniste**, të cilat i diskutojmë në vijim të këtij seksioni. Aty kur përdoret precedenti në vendet e sistemit civil, më shumë bëhet fjalë për përdorimin e tij si argument për arsyetim të rasteve konkrete. Kjo bëhet për të treguar se fjala është për përsëritje të vazhdueshme të rasteve të njëjta apo të ngjashme ashtu që krijojnë bindje te gjyqtari i rastit për t'i përdorur si një argument arsyetues. Kjo në veçanti vlen për situatat kur ekzistojnë precedente të njëjta apo të ngjashme të gjykatave me të larta në hierarkinë gjyqësore. Kjo ndryshe njihet me emrin **jurisprudence constante**, për të cilën flitet në vijim të këtij seksioni: në ndërkohë që në sistemin e të **drejtës së përgjithshme** precedenti përbën burim formal të së drejtës, në sistemin civil të së drejtës nuk bëhet fjalë për precedentin si burim formal të së drejtës, por për precedentin si argument mbështetës dhe inspirim për arsyetim të vendimmarrjes konkrete.[32]

Në këtë kuptim ravijëzohen qartë dy qasje lidhur me rolin dhe pozitën kushtetuese të precedentit: në rastin e parë bëhet fjalë për arsyetim të vendimmarrjes gjyqësore me mbështetje në praktikën e mëhershme gjyqësore, kurse në të dytin për vendimmarrje gjyqësor me mbështetje në ligj, duke përdorur praktikën e mëparshme gjyqësore vetëm në hije si një udhëzim inspirues.

Janë tri arsye për një qasje të tillë ndaj praktikës gjyqësore në sistemin civil të së drejtës: arsyeja e parë ka të bëjë me ekonominë mentale të gjyqtarëve, përkatësisht me faktin që gjyqtarët e kanë më të lehtë për të ndjekur precedentet e kolegëve të vet se të zhvillojnë vetë praktikë të re gjyqësore nga fillimi; arsyeja e dytë ka të bëjë me sigurinë dhe stabilitetin juridik, njëjtë si në rastin e sistemit të së drejtës së përgjithshme, pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për gjykatat e nivelit të njëjtë, më të lartë apo edhe me gjykata të niveleve më të ulëta; arsyeja e tretë dhe e fundit ka të bëjë me pozitën dhe rolin kushtetues të gjykatave supreme apo gjykatave të larta në hierarkinë e gjyqësorit nacional, përkatësisht me pozitën më të lartë të tyre në hierarkinë gjyqësore, roli primar i të cilave konsiston në sigurimin e zbatimit uniform të ligjit në tërë territorin shtetëror.[33]

Kjo që u tha më sipër, vlen për sferën e të **drejtës civile**: në këtë sferë dhe në marrëdhëniet që rregullon kjo degë e së drejtës, me të drejtë është vërejtur se precedentët dhe e drejta e precedentëve janë stabile dhe nuk ndryshojnë lehtë dhe shpejt. Për ndryshimin e tyre kërkohet një kohë e gjatë dhe një ndryshim gradual. Në këtë drejtim, përjashtim bën fusha e të **drejtës kushtetuese**, që është objekt i fokusit tonë në këtë libër: ndryshimet shoqërore janë më të shpeshta dhe më të shpejta, ashtu që edhe precedenti në këtë sferë të së drejtës është më pak stabil dhe më i diskutueshëm. Në sferën e të drejtës kushtetuese, siç e ka thënë një autor amerikan, ashtu si ndryshon pasqyra duhet

---

30 Vincy Fon & Francesco Parisi, "Judicial precedents in civil law systems: A dynamic analysis", fq. 522, fusnota 9, (ku autorët citojnë autorin e njohur italian **Calamndrei**, i cili me ironizëm ka thënë se sa më shumë që po kalonte koha, me shumë po i shtoheshin rezervat ndaj logjikës juridike të sanksionuar në kode e ligje të shkruara, të cilat nuk kishin asnjë ndjeshmëri ndaj ndryshimeve radikale të gjendjeve faktike që duheshin adresuar nga gjyqtarët në rastet konkrete).

31 Charles Soule, "Stare Decisis in Continnetal Europe", fq. 460-461 (ku autori përmend rastet e **Austrisë, Hungarisë, Italsië**, **Spanjës** dhe **Zvicrës** si vende që **de facto** roli i precedentit ka qenë i madh në këtë kohë).

32 D. K. Lipstein, "The Doctrine of Precedent in Continental Law with Special Reference to French and German Law", fq. 34-44.

33 Ibid. fq. 36-37.

të ndryshojë edhe reflektimi i saj.[34] Kjo nënkupton që, në gjyqësinë kushtetuese, marrëdhëniet shoqërore që janë objekt i vendimmarrjes, përfshijnë gjykime kushtetuese lidhur me peshën e parimeve kushtetuese, jo aq shumë gjykime lidhur me normat kushtetuese konkrete, të cilat janë skajshmërisht të përgjithshme dhe nuk dallojnë shumë nga parimet. Të rralla janë rastet kur normat kushtetuese janë të qarta dhe nuk kërkojnë interpretim shtesë më qëllim të saktësimit të tyre, gjë që nuk është rasti në sferën e të **drejtës civile** ku normat janë më të qarta dhe më precize. Të tilla norma, me shumë kuptime që kërkojnë sqarime e saktësime shtesë, janë normat që, ta zëmë, rregullojnë përbërjen e parlamentit nacional, të ekzekutivit, kushtet për zgjedhjen e organeve qendrore të pushtetit dhe kështu me radhë. Situata nuk është më e mirë me normat tjera kushtetuese, me ato që përbëjnë pjesën dërrmuese të tekstit kushtetues, siç janë normat që kanë të bëjnë me ndarjen dhe balancimin e pushteteve, liritë dhe të drejtat kushtetuese etj. Këto norma janë të mbarësuara me përgjithësime, aq sa ruajtja dhe kultivimi i precedentëve lidhur me to kërkon mund dhe kohë të gjatë. E njëjta vlen për ndryshimin e tyre: ndryshimi i precedentit kushtetues në këto sfera të marrëdhënieve kushtetuese është i ngadalshëm, i pjesshëm dhe me fragmente. Kjo vlen si për **sistemin civil të së drejtës** ashtu edhe për **sistemin e të drejtës së përgjithshme**.[35]

Lirisht mund të thuhet se precedenti nuk ka pasur asnjë vend në teorinë dhe praktikën e vendeve ish-komuniste. Koha e eliminimit të tërësishëm të precedentit në këto vende ka nisur me fitoren e komunizmit në **Rusi** dhe krijimin e **BRSS** (1922-1991). Emërues i përbashkët i kësaj kohe është eliminimi i tërësishëm i teorisë dhe praktikës së **stare decisis**. Nuk është se këto vende kanë pasur ndonjë traditë të pasur me stare decisis para hyrjes së tyre në orbitën komuniste. E kemi fjalën këtu për vendet ish-komuniste të Evropës Qendrore dhe Juglindore, që ranë nën orbitën sovjetike pas vitit 1945. Konceptin francez për gjyqtarin si **bouche de la loi**, komunizmi sovjetik pas vitit 1922 e **ç**oi deri në përmasa absurde: gjyqtari sovjetik komunist ishte një shërbëtor i verbër i ligjit, i normave juridike skajshmërisht të ideologjizuara. Jo vetëm kaq! Ata gjyqtarë nuk ishin të detyruar të arsyetonin dhe publikonin vendimet e tyre. Në fakt, e kishin të ndaluar arsyetimin e tyre: vendimet gjyqësore nuk duhej të arsyetoheshin e as të botoheshin sepse supozohej që ato e reflektonin gjendjen e saktë të paracaktuar nga ligjvënësi apo autoritetit tjetër që kishte prodhuar normën juridike (individuale apo të përgjithshme).[36] Kjo traditë sovjetike më pas u instalua në të gjitha vendet ish-komuniste të **Evropës**, pas vitit 1945, me intensitet të ndryshëm. Kjo traditë qëndron prapa perceptimit të përgjithshëm mbi gjyqtarët e kompromentuar të këtyre vendeve. Në të njëjtën kohë, kjo përbën edhe një ndër arsyet kryesore pse shumica e vendeve ish-komuniste, përfshirë **Kosovën**, zgjodhën rrugën e themelimit të gjykatave kushtetuese, të ndara nga gjyqësori i rregullt dhe të stafuara me gjyqtarë dhe personel tjetër që nuk i ka shërbyer sistemit komunist.

Kjo gjendje ka qenë ndryshe në Evropën jo-kontinentale: në **Britaninë e Madhe**, që nga **Mesjeta** e hershme ka ekzistuar një vëmendje e duhur dhe respekt ndaj precedentit gjyqësor. U mor vesh, këtu bën përjashtim **Skocia**, e cila, në këtë drejtim, pak a shumë i ngjason pjesës tjetër të **Evropës.** Në pjesën tjetër të **Britanisë së Madhe**, precedenti ka qenë, pa asnjë diskutim, burim formal i së drejtës. Kjo gjendje është kështu dhe sot. Shikuar në aspektin historik, lindja e pozitivizmit në **Angli** nën ndikimin e **Xheremy Bentam (Jeremy Bentham: 1748-1832)** ka qenë ndër arsyet kryesore që ka rrënjosur doktrinën **stare decisis**: deri në fund të shekullit XVIII dhe fillimin e shek. XIX, **stare decisis** kishte pasur vetëm një forcë argumentuese inspirative, kurse pas kësaj periudhe fitoi në mënyrë graduale statusin e burimit formal të së drejtës. Në ndërkohë që në sistemin civil të së drejtës, nxjerrja e ligjeve shihej si një aktivitet i domosdoshëm për të rritur sigurinë juridike dhe për të ngushtuar hapësirën e rrezikut që buronte nga zbatimi i precedentëve, në **Angli** kjo përfundimisht synohej të arrihej përmes sanksionimit me ligj të **stare decisis** si burim primar formal-juridik i së drejtës. Ky synim u

[34] Charles Aikin, "Stare Decisis, Precedent and the Constitution". *The Western Political Quarterly* Vol. 9, No. 1 (Mar., 1956), fq. 87-92 në fq. 92.

[35] Për një analizë të këtij aspekti në kontekstin amerikan, deri në mohim të doktrinës **stare decisis**, cf. më shumë në Ibid. fq. 87-92.

[36] Cf. Frank Emmert, "Stare Decisis: A Universally Misunderstood Idea", fq. 214-219.

intensifikua në fund të shekullit XVIII dhe në fillim shekullit XIX.[37] Sanksionim ligjor i epërsisë së **stare decisis** dilte si një rezultat i fuqizimit të pozitivizmit në këtë vend: kjo u pa qartë me nxjerrjen në vitin 1873 të një ligji mbi gjyqësorin, i njohur si **Ligji mbi Gjykatat** (**Judicature Act**). Ky ligj krijoj juridiksionin e apelit dhe gjykatën e lartë, ashtu që sistemi gjyqësor britanik u bë hierarkik. Kjo nënkuptonte se gjykatat e ulëta tani e tutje detyroheshin t'u përmbaheshin vendimeve të mëparshme të dhëna nga apeli.[38] Kjo ishte e kundër me kuptimin e pozitivizmit në Gjermani, që e shihte burimin e së drejtës në vullnetin e popullit, jo në fuqinë e gjykatave dhe në interpretimet gjyqësore.[39]

Aktet juridike si më sipër plotësonin mozaikun e shkaktarëve imediat që çuan në lindjen e doktrinës **stare decisis** në **Britani**, përkatësisht në lindjen e shkaktarit tjetër të radhës: që nga **Mesjeta** e hershme, në **Angli** ka ekzistuar një përpjekje për të prodhuar raporte vjetor apo vjetar përmbledhës të vendimeve gjyqësore me qëllim të rritjes së sigurisë dhe ndërtimit të një praktike gjyqësore konsistente. Përpjekjet e tilla për botim u kurorëzuan në vitin 1865 me themelimin e një trupi të veçantë, në ngarkesë të të cilit ishte publikimi i raporteve të përmbledhura të vendimet gjyqësore. Ky trup quhej **Raportimi Përmbledhës i Këshillit të Drejtësisë** (**Incorporated Council of Law Reporting**).[40] Sikundër shihet, publikimi i vendimeve të përmbledhura ka qenë kusht i domosdoshëm, por jo i mjaftueshëm, për themelimin e **stare decisis** si burim formal i së drejtës: nxjerrja e **Ligji mbi Gjykatat** përligjësoi precedentin si burim formal të së drejtës.[41] Vite më vonë ky përligjësim do të marrë vulën përfundimtare nga vetë gjyqësori britanik, në rastin e njohur **London Tramways co. v. London County Council** (1898), me të cilin **Dhoma e Lordëve** theksoi se e konsideronte veten ligjërisht të lidhur (detyruar) me **ratio decidendi** *të vendimit të saj të mëhershëm.*[42] Kjo nënkupton se në Angli **stare decisis** ka marrur formën e sotme kah fundi i shek. 18-të, për t'u bërë burim primar i detyrueshëm i së drejtës në dekadat e fundit të shekullit në vijim.[43]

Sa i përket çështjes së precedentit si burim formal i së drejtës, nga shqyrtimi tona deri këtu, sikur duket që ka një ndarje bardh e zi në mes të dy sistemeve, sistemit civil dhe sistemit të së **drejtës së përgjithshme**. Kjo, megjithatë, nuk është kështu nisur nga fakti se ekziston një konvergjencë në mes të dy sistemeve të së drejtës sa i përket rolit dhe rëndësisë së precedentëve. Është cilësia e vendimeve ajo që ka përcaktuar këtë konvergjencë: ekzistojnë vendime të arsyetuara mirë dhe vendime të arsyetuara keq, pa marrë parasysh nëse si burim i së drejtës ka shërbyer precedenti apo norma e shkruar juridike.[44] Siguria juridike, si një komponentë jashtëzakonisht e rëndësishme e sundimit të ligjit arrihet vetëm përmes vendimeve të arsyetuara mirë, pa marrë parasysh burimin e së drejtës. Kjo në veçanti vlen për gjyqësinë kushtetuese, marrë parasysh natyrën shumë të përgjithshme dhe parimore të normave të së drejtës kushtetuese që i interpreton.

---

37 Vincy Fon & Francesco Parisi, "Judicial precedents in civil law systems: A dynamic analysis", fq. 522; Charles J. Reid, Jr., "Judicial Precedent in the Late Eighteenth and Early Nineteenth Centuries: A Commentary on Chancellor Kent's Commentaries" *Ave Maria Law Review* Vol. 5 No. 1 (2007) fq. 47-112, në veçanti fq. 101-112. (ku autori shpjegon se në **SHBA**, njëjtë si në **Angli**, në fund të shek. XVIII dhe në fillim të shek. XIX **stare decisis** dhe e drejta e precedentëve bazoheshin në arsyetime të së drejtës natyrore dhe në arsye të tjera transcendente, në ndërkohë që kjo gjendje ka nisur të ndryshojë pas vitit 1830, kur besnikëria ndaj origjinalizmit të tekstit kushtetues ka mbizotëruar çdoherë e më shumë).

38 Willis B. Perkins, "The English Judicature Act of 1873". *Michigan Law Review* Vol. 12 No. 4 (February 1914), fq. 277-292.

39 Cf. fusnota nr. 24, **supra**, si dhe komentet tona që e shoqërojnë.

40 Michael Bryan, "The modern history of law reporting". *University of Melbourne Collections* Issue 11 (December 2012), fq. 32-36.

41 Në **Francë** deri pas revolucionit, kurse në **Gjermani** në mesin e shek. XIX nuk ka ekzistuar një infrastrukturë ligjore që ka normuar hierarkinë e institucioneve të gjyqësorit. Në literaturë, kjo rrethanë përbën një cilësi që flet për pengesën serioze të këtyre dy vendeve për të ngritur stare decisis në rang të burimit formal të së drejtës. Mungesa e hierarkisë institucionale gjyqësore në këto dy vende në këtë kohë ka shkaktuar kakofoni precedentesh, përkatësisht një kaos në sistemin e precedetneve sepse nuk kanë ekzistuar rregulla të qarta mbi atë se cili nivel i gjyqësorit duhet të bazohet në stare decisis si burim i së drejtës. Në **Angli**, nxjerrja e ligjeve mbi hierarkinë gjyqësore ka bërë që të përligjësohet përfundimit praktika e deriatëhershme e precedenteve si burime të së drejtës. Cf. më shumë në D. K. Lipstein, "The Doctrine of Precedent in Continental Law with Special Reference to French and German Law", fq. 42-43.

42 D. K. Lipstein, "The Doctrine of Precedent in Continental Law with Special Reference to French and German Law",fq. 44.

43 Stephen Waddams, "Review: Authority, Precedent, and Principle", fq. 127.

44 Frank Emmert, "Stare Decisis: A Universally Misunderstood Idea", fq. 213-214

Në vijim si më sipër, kur e kemi fjalën për precedentin në gjyqësinë kushtetuese që modelohet sipas **sistemit kelsenian/evropian**, në të cilin bën pjesë edhe **Kosova**, shënojmë menjëherë se në këto vende vendimet e gjykatave kushtetuese shërbejnë si **stare decisis** për të gjitha rastet që vendosen apo zgjidhen më pastaj nga autoritetet publike nacionale. I vetmi përjashtim në këtë drejtim është se nuk ekziston **stare decsis** për vetë gjykatën kushtetuese, e cila vetë ka vendosur një rast apo ka zgjidhur një mosmarrëveshje të mëhershme kushtetuese: **ratio decidenti** e vendimit të saj të mëhershëm mund të ndryshoj, gjithnjë me një arsyetim bindës dhe të hollë. Tjerët që janë në pozitën e organit që vendos, duhet t'i nënshtrohen në tërësi **ratio decidenti** të gjykatës kushtetuese, duke e marrë të njëjtin si të mirëqenë. Kjo është kështu sepse vetëm gjykata kushtetuese mund të ndryshojë praktikën e vet gjyqësore, me një arsyetim të gjatë, të hollë dhe relevant. Ky status kushtetues i **stare decisis** të vendimeve të **gjykatave kushtetuese kelseniane** vlen edhe për gjyqësorin e rregullt dhe të tjerët, të cilët duhet në tërësi të vendosin sipas interpretimit të dhënë nga gjykata kushtetuese në **ratio decidendi** të vendimit të vet.

Në rastin e gjyqësorit të rregullt, ndërkaq, precedentët në aspektin formal nuk paraqiten si burim i së drejtës. Këtë cilësi i kanë vetëm **de facto:** ato kanë një ndikim të jashtëzakonshëm faktik për shkak të fuqisë së tyre arsyetuese bindëse. Këtë e kemi cilësuar më sipër si **fuqi inspiruse** argumentative e vendimeve të mëhershme. Kjo nënkupton se, thënë me fjalë të tjera, **stare decisis** nuk paraqet një burim të detyrueshëm të së drejtës për nivelet e ulta të gjyqësorit në një vend me sistem civil të së drejtës, por vetëm si një burim **de facto** i arsyetimit dhe ndërtimit të bindjes me rastin e vendosjes së rasteve të njëjta apo ngjashme. Në këtë sistem, gjykatat ndjekin praktikat e kaluara vetëm atëherë kur ekziston një nivel i kënaqshëm i konsistencës në praktikën gjyqësore. Në këto raste gjykatat e marrin parasysh precedentin nga e kaluara si një **burim të butë** të së drejtës (**soft law**). Statusi i precedentit të tillë, megjithatë, nuk hyn në kategorinë e burimit të rregullt formal: precedenti që ka uniformitet dhe konsistencë të mjaftueshëm gjatë përsëritjes shërben si një argument shtesë që ndihmon në ndërtimin e bindjes dhe formimin e arsyetimit të gjykatës që shërbehet me te.[45] Për dallim nga gjyqësori i rregullt, në gjyqësinë kushtetuese precedenti gjen zbatim dhe përfshinë, njëjtë si në sistemin e të drejtës së përgjithshme, si anën faktike ashtu atë juridike të problemit. Thënë me fjalë të tjera, **ratio decidendi** është i njëjtë konceptualisht në lëmin e gjyqësisë kushtetuese në dy sistemet e së drejtës: dallimet në mes tyre janë vetëm sa i përket teknikës së përdorimit të precedentit.

Zhvillimet përgjatë shekullit XX katërçipërisht kanë vërtetuar atë që thamë më sipër, përkatësisht se ka një kohë të gjatë që vendet e sistemit civil kultivojnë një respekt **de facto** për **stare decisis**. Në lëmin e gjyqësisë kushtetuese, sikundër u tha, një gjë e tillë as nuk diskutohet, në veçanti kur bëhet fjalë për vendet e këtij sistemi që kultivojnë gjyqësi kushtetuese të **modelit kelsenian/evropian** me gjykatë të ndarë kushtetuese (apo me juridiksion të ndarë kushtetues, ushtrimi i të cilit gjendet në duart e instancës më të lartë gjyqësor në vend). Në këto vende, **stare decis** garantohet përmes kushtetutës nacionale: në nivel nacional, vendimet e gjykatës kushtetuese gëzojnë statusin e **stare decisis** përmes sanksionimit kushtetues të efektit së tyre të përgjithshme (**erga omnes**).

Ky efekt është më i gjerë se koncepti **stare decisis** dhe nënkupton efektin e përgjithshëm të vendimeve të gjykatës kushtetuese, pa marrë parasysh nëse ato vihen në zbatim në vendimmarrjen e ardhshme të ndonjë organi tjetër publik. Kjo në veçanti vihet në dukje në vendimet që kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat e njeriut: zbatimi i tyre i drejtpërdrejtë ka bërë që të krijohet një standard uniform i aplikimit të dispozitave kushtetuese për liritë dhe të drejtat e njeriut. Ky standard me ashpërsi edhe më të madhe vlen për sferën e jurisprudencës kushtetuese në lëmin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjera juri-

[45] Me termin **e drejtë e butë** nënkuptohet burimi i së drejtës që nuk figuron në menynë (listën) kushtetuese të burimeve të së drejtës apo në praktikën gjyqësore të një vendi, mirëpo ka një fuqi të madhe bindëse dhe shërben për të arsyetuar vendimet gjyqësore. Në sistemin civil të së drejtës e a.q. **jurisprudence constante**, si një pandan i **stare decisis**, ka statusin e një të **drejte të butë** vetëm nëse praktika gjyqësore është koherent dhe uniforme, pa fragmentime. Fuqia e "precedentit" në sistemin e të drejtës civile buron nga praktika e konsoliduar gjyqësore në një çështje të caktuar. Kur ekziston një qarje apo fragmentim në praktikën gjyqësore atëherë nuk mund të bëhet fjalë për fuqinë (autoritetin) detyrues të praktikës së mëparshme gjyqësore. Cf. më shumë në Vincy Fon & Francesco Parisi, "Judicial precedents in civil law systems: A dynamic analysis", fq. 519–535.

dike. Këto dy sfera janë ato në kuadër të të cilave realizohet **stare decisis** përmes realizimit të efektit të përgjithshëm (**erga omnes)** të vendimeve gjyqësore. Jashtë këtyre dy sferave, në gjyqësinë kushtetuese të sistemit civil të së drejtës mund të bëhet fjalë vetëm për efektet e përgjithshme juridike (**erga omnes**) të vendimeve të gjykatës kushtetuese, efekte që garantohen me kushtetutë në nivel nacional. Kjo nuk është domosdoshmërisht e njëjtë me **stare decisis**, në kuptim të asaj që vendimi i mëhershëm duhet të ndiqet nga ana e gjyqtarëve që vendosin një rast apo zgjidhin një mosmarrëveshje konkrete në të tashmen. Kjo çështje, përkatësisht efekti i përgjithshëm (**erga omnes)**, siç e thamë më sipër, paraqet një çështje tjetër. Njëjtë vlen edhe për efektin **res judicata**: një çështje quhet e gjykuar dhe zakonisht shërben si precedent. Si precedent mund të shërbejë edhe rasti që ka ndryshuar si praktikë gjyqësore, mirëpo që tanimë ka prodhuar efektin **res judicata**. Ajo që ka qenë **ratio decidendi**, në dy rastet e **res judicata**, mund të shërbejnë si bazë për vendimmarrje në një gjykim të mëvonshëm identik apo të ngjashëm. Ai precedent, jo domosdo shërben për të vërtetuar një prononcim të caktuar të gjyqtarit që vendos tani: ai mund të shërbejë për të vërtetuar, mohuar apo ndryshuar një verdikt të gjyqtarit kushtetues për një rast apo mosmarrëveshje konkrete.

Ky shtjellim si më sipër përbën arsyen e duhur që ne këtu të diskutojmë aspektet konkrete dhe krahasimore të rolit dhe pozitës së precedentit në gjyqësinë kushtetuese kosovare, një rol dhe pozitë që i ka rrënjë të forta në dispozitat kushtetuese të miratuara në vitit 2008.

13.2. Statusi kushtetues i të drejtës ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut

Liritë dhe të drejtat e njeriut bëjnë pjesë në atë pjesë të së drejtës kushtetuese që figurojnë shumë lart në kushtetutat moderne, jo vetëm të ish-vendeve komuniste,[46] por edhe të vendeve me traditë të gjatë demokratike.[47] Rasti i **Francës** dhe i Kushtetutës së vitit 1958 përmendet si përjashtim i një vendi demokratik që nuk përmban një katalog të qartë të lirive dhe të drejtave të individit.

Normat për liritë dhe të drejtat e njeriut zakonisht figurojnë pas dispozitave themelore të kushtetutës nacionale. Përjashtimet janë të rralla, si p.sh. rasti i **Ligjit Themelor të Gjermanisë** ku katalogu i lirive dhe të drejtave të njeriut figuron menjëherë pas preambulës. Një qasje si kjo është bërë me qëllim që të pengohen përsëritjet e gabimeve të **Kushtetutës së Vajmarit** (1919).[48] Kjo, megjithatë, përbën përjashtim. Si rregull, ndërkaq, katalogu i lirive dhe të drejtave njerëzore vjen pas dispozitave themelore dhe parimeve të përgjithshme. Kosova nuk bën përjashtim në këtë kuptim: liritë dhe të drejtat e njeriut në Kushtetutë zënë një vend të spikatur dhe, për dallim nga kushtetutat e vendeve ish-komuniste, gjenden të grumbulluara në dy kapituj, në kapitullin e dytë dhe të tretë respektivisht. Përmbajtja e tyre shtretëzohet fuqishëm në të drejtën ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut. Ky *shtretëzim në të drejtën ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut lidhet me historinë e kaluar të Kosovës, në veçanti kur bëhet fjalë për vlerat dhe parimet që mëton të sanksionojë kapitulli i tretë i Kushtetutës. Marrëdhënia në mes të drejtës ndërkombëtare dhe të drejtës kushtetuese kosovare, me plot të drejtë në literaturë është cilësuar si një marrëdhënie e çiltër.*[49]

Normat kushtetuese të këtyre dy kapitujve kanë një status të privilegjuar. Kjo vjen nga dy burime: nga vetë Kushtetuta dhe nga zotimi i njëanshëm ndërkombëtar i Kosovës për të vënë në jetë në tërësi germën

---

46 Cf. Ruth Gavison, "What Belongs in a Constitution?" *Constitutional Political Economy* Vol. 13 No. 1 (2002), fq. 89 – 105, në fq. 95 (ku autori thekson se në të gjitha vendet ish-komuniste, katalogu i lirive dhe të drejtave të njeriut figuron menjëherë pas dispozitave të përgjithshme apo themelore).

47 Cf. Gennady M. Danilenko, "The New Russian Constitution and International Law". *The American Journal of International Law* Vol. 88 No. 3 (1994), fq. 451-470, në fq. 453. ("Normat e të drejtës ndërkombëtare që zakonisht figurojnë nëpër kushtetutat moderne të demokracive kushtetuese kanë të bëjnë me rregullimin kushtetues të fushave që lidhen me: 1. kapacitetin kontraktues të shtetit në planin kontraktues; 2. marrëdhëniet në mes të drejtës së brendshme dhe asaj ndërkombëtare; 3. promovimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut; 4. pjesëmarrjen në institucionet ndërkombëtare; dhe 5. përdorimin e forcës së armatosur jashtë vendit").

48 Nigel Foster & Satis Sule, *German Legal System and Laws* (Oxford: Oxford Universoty Press, 2010), fq. 160-161.

49 Visar Morina, Fisnik Korenica dhe Dren Doli, "The Relationship between International Law and National Law in the Case of Kosovo: A Constitutional Perspective" *International Journal of Constitutional Law* Vol. 9 No. 1 (2011), fq. 274-296, në fq. 283.

dhe shpirtin e **Planit Ahtisari** (2007),[50] zotim që ka efekt **erga omnes**. Cilësia e fundit ka të bëjë, në rend të parë dhe mbi të gjitha, me mbrojtjen e komuniteteve pakicë dhe qeverisjen e mirë, për çka **Kosova** po ashtu është zotuar ndërkombëtarisht në mënyrë të njëanshme ditën e shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt 2008. Kjo nënkupton se **Deklarata e Pavarësisë** e datës 17 shkurt 2008 përbën një **grundnorm** të Kosovës sovrane dhe të pavarur nga e cila rrjedh detyrimi ndërkombëtar për garantimin e një statusi të privilegjuar të dy kapitujve të Kushtetutës që kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat e njeriut. Këtë e kemi theksuar më herët, në seksionin 10.3 të kapitullit dhjetë, kur kemi folur për lindjen dhe konsolidimin e **grundnorm**-ës së **Kosovës** në kontekstin e lindjes dhe zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese, dje dhe sot.

Kushtetuta nuk bën kategorizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut sipas gjeneratës, përkatësisht sipas kohës së lindjes dhe natyrës së tyre.[51] Këtë zakonisht nuk e bëjnë as kushtetutat tjera. Në rastin e **Kosovës**, megjithatë, me shumë lehtësi mund të zbulohet se në këta dy kapituj gjenden të përmbledhura liritë dhe të drejtat që i takojnë tri gjeneratave të të drejtave të njeriut.[52] Historikisht shikuar, ndërkaq, lindja e tyre sipas gjeneratave i ngjason valëve: vala e parë, që ka nisur me **Revolucionin Francez** (1789), ka dhënë shkas për lindjen e gjeneratës së të drejtave civile dhe politike (gjenerata e parë). Me valën e dytë, pas **Revolucionit të Tetorit** (1917), të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore fituan një njohje universale (gjenerata e dytë). Në fund, vala e tretë, në mes të shekullit 20, ka pasuar emancipimin e popujve të kolonizuar me shekuj nga kolonizatorët evropianë (gjenerata e tretë).[53]

Shtylla privilegjuese e dy kapitujve si më sipër kundrejt normave të tjera të Kushtetutës gjendet kryesisht në redaktimin e nenit të saj 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]. Ky nen përcakton listën e marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare në sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut, të cilat zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kosovë.[54] Kështu, siç figurojnë në këtë nen, pak a shumë kanë figuruar edhe në **Kornizën Kushtetuese** (2001),[55] në **Planin Ahtisari**

---

50 **Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës** (2 shkurt 2007) (**Plani Ahtisari**). Në internet: http://oldkuvendikosoves.org/common/docs/Propozim%20per%20Statusin%20e%20Kosoves.pdf (shikuar në mars 2017).

51 Karel Vasak, "A 30-year struggle: The sustained efforts to give force of law to the Universal Declaration of Human Rights". *The UNESCO Courier XXX*, no. 11 (1977), fq. 28-32, në fq. 29; Këtë kategorizim e ka bërë për herë të parë **Karel Visak** në vitin 1977.

52 Në literaturë flitet edhe për gjeneratën e katërt të të drejtave të njeriut. Në këtë kategori hyjnë të a.q. të drejtat që kanë të bëjnë me inxhinieringun gjenetik. Këto të drejta janë në nivel debati doktrinar. Në gjeneratën e katërt të të drejtave mund të hyjnë edhe të a.q. të drejtat e gjeneratave të ardhshme, të cilat nuk i takojnë as individit e as grupeve shoqërore, përfshirë kombet, por njerëzimit si tërësi. Këtu mund të futen edhe të drejtat e eksploatimit dhe eksplorimit të kozmosit. Thënë me fjalë tjera, gjenerata e katërt e të drejtave përfshin ato të drejta që aktualisht nuk ka konsensus apo pajtueshmëri të madhe rreth përmbajtjes së tyre si dhe nivelit të mbrojtjes që duhet ofruar. Kështu, ta zëmë, në debat dhe kontestueshmëri permanente janë çështjet siç janë ndihma në eutanazi (e drejta për të vdekur në paqe dhe me dinjitet), mbajtja e personit në jetë në mënyrë artificiale pas vdekjes së trurit, sterilizimi, statusit i fetusit, infanticidi (abortimi i vonshëm) etj. etj.

53 Antonio Cassese, "Modern Constitutiutions and International Law". *Collected Courses of the Hague Academy of International Law* 192 (Leiden/Boston: Brill/Nijhoff, 1985), fq. 351-367; Për më shumë rreth kësaj, cf. edhe P. H. Kooijmans, "Human Rights – Universal Panacea? Some Reflections on the So-called Human Rights of the Third Generation" *Netherlands International Law Review* Vol. 37 No. 3 (1990), fq. 315-329.

54 Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] i Kushtetutës:
"Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:
(1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
(2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
(3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;
(4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
(5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
(6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
(7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
(8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore,
Jonjerëzore dhe Poshtëruese"

55 **Kornizë Kushtetuese për Vetëqeverisje në Kosovë** (15 maj 2001), kreu 3 [Të Drejtat e Njeriut] dhe kreu 4 [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Anëtarëve të tyre].

(2007),[56] dhe në **Kushtetutën e Rambujesë** (1999).[57] Sikundër dihet, kjo e fundit asnjëherë nuk ka gjetur zbatim në **Kosovë** si pasojë e rrethanave të krijuara nga lufta me **Serbinë** dhe ndërhyrja ushtarake e **NATO**-s kundër trupave ushtarake dhe paramilitare serbe në **Kosovë** gjatë muajve mars - qershor 1999. Kjo teknikë juridike e inkorporimit të dokumenteve relevante regjionale dhe ndërkombëtare mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, që sot figuron në Kushtetutë, në mënyrë efektive për herë të parë është futur në sistemin juridik kosovar gjatë kohës së administrimit ndërkombëtar të **OKB**-së: **Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/24** ka përqafuar qasjen e njëjtë me atë që sot reflektohet në dispozitat kushtetuese kosovare.[58] Një qasje e tillë i konsideron si pjesë përbërëse dhe të pandarë të sistemit kushtetues, me vlerë të njëjtë juridike si çdo normë kushtetuese, një grup të caktuar të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare mbi liritë dhe të drejtat e njeriut. Një situatë e njëjtë ekziston edhe në **Bosnje-Hercegovinë**, ani se atje inkorporimi i tyre është bërë përmes një marrëveshjeve ndërkombëtare, **Marrëveshjes së Dejtonit** (1995),[59] pjesë e së cilës është edhe vetë kushtetuta e këtij vendi.

Në nivel evropian, ndërkaq, qasjet ndaj statusit të **KEDNJ** në rendin e brendshëm juridik janë të ndryshme.[60] Në shumë pak vende statusi i saj është kushtetues, siç është rasti me **Kosovën.** Teknika juridike e përdorur për inkorporim të saj në rendin e brendshëm të këtyre vendeve, megjithatë, ndryshon nga rasti ynë sepse kryhet përmes procedurave standarde të ratifikimit kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare. I tillë është rasti, ta zëmë, me **Austrinë** dhe **Holandën.**[61] Në rastet tjera, **KEDNJ** gëzon një status **super-legjislativ**, që nënkupton se rri mbi çdo normë ligjore në nivel nacional me efekt retroaktiv, duke shfuqizuar çdo normë të mëhershme që bie ndesh me te. I tillë është rasti, ta zëmë, me **Belgjikën** dhe **Spanjën.**[62] Në spektrin e skajshëm, farë në fund, ekzistojnë vendet që **KEDNJ**-së i japin statusin e ligjit të zakonshëm. I tillë është rasti, ta zëmë, me **Gjermaninë** dhe **Italinë.**[63]

Teknika juridike, si më sipër, dallon thelbësisht nga teknika e inkorporimi në të drejtën e brendshme të marrëveshjeve dhe instrumenteve tjera ndërkombëtare përmes marrjes së tyre përsipër nga ana e organeve të Kosovës, përfshirë këtu ratifikimin në kuvend. Për këto raste vlejnë dispozita të tjera kushtetuese, ato nga neni 19 ["Zbatimi i të Drejtës Ndërkombëtare"] i Kushtetutës. Këto dispozita normojnë marrëdhënien në mes të drejtës kushtetuese kosovare dhe të drejtës ndërkombëtare, marrëdhënie që, sikundër u tha, ka natyrë të marrëdhënies së *çiltër dhe miqësore*. Të natyrës së njëjtë janë edhe dispozitat e nenit 20 ["Bartja e Sovranitetit"] të Kushtetutës. Marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, të cilat kanë për pasojë bartjen e sovranitetit domosdo që prekin edhe liritë dhe të drejtat e njeriut. Kjo është arsyeja që në të gjitha shtetet sovrane dhe të pavarura të demokracive kushtetuese figurojnë dispozita të tilla të qarta lidhur me teknikat juridike të bartjes së sovranitetit shtetëror. Arsyeja për qartësi të tillë të këtyre dispozitave qëndron çdoherë në të drejtën ndërkombëtare: sovraniteti i shtetit në të drejtën dhe marrëdhëniet ndërkombëtare prezumohet ashtu që çdo përjashtim eventual nga kjo rregull duhet të vihet në dukje në mënyrë të qartë në marrëdhëniet në mes të shteteve.

---

56 **Plani Ahtisari**, neni 2 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut] dhe neni 3 [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre].

57 **Marrëveshja e Rambujesë – Marrëveshja e përkohshme për paqe dhe vetëqeverisje në Kosovë** (shkurt – mars 1999), neni VI [Liritë dhe të Drejtat Themelore] dhe neni VII [Komunitetet Nacionale].

58 **Rregullore nr. 1999/24 për Ligjin në Fuqi në Kosovë** (12 dhjetor 1999), neni 1.3 (me të cilën dispozitë përcaktohej lista e instrumenteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut që vlenin si e drejtë pozitive kosovare, listë që është e ngjashme me atë që sot figuron në nenin 22 të **Kushtetutës së Kosovës**).

59 **The General Framework Agreement for Peace in Bosnia and Herzegovina** (1995). Në internet: https://www. osce.org/bih/126173?doënload=true (shikuar në mars 2017).

60 Cf. më shumë për statusin e **KEDNJ** në vendet evropiane, në Giuseppe Martinico, "Is the European Convention Going to Be 'Supreme'? A Comparative-Constitutional Overvieë of ECHR and EU Law before National Courts". *The European Journal of International Law* Vol. 23 No. 2 (2012), fq. 401-424; Lize R. Glas, "The Boundaries to Dialogue with the European Court of Human Rights: Exploring Patterns of Repetitive Violations". *European Yearbook of Human Rights* (2018), fq. 287-317.

61 Lize R. Glas, "The Boundaries to Dialogue with the European Court of Human Rights: Exploring Patterns of Repetitive Violations", fq. 300-301; 308.

62 Ibid., fq. 301-303, 310.

63 Ibid., fq. 303-306.

Dispozitat e qarta kushtetuese në kuptimin si më sipër ndryshe quhen edhe dispozita autorizuese sepse autorizojnë organet përfaqësuese nacionale për të bartur një pjesë të sovranitetit shtetëror sipas një procedure të pacaktuar dhe në një fushë të qartë kushtetuese. Të shohim në vijim si duket marrëdhënia e *çiltër e të drejtës kushtetuese kosovare me të drejtën ndërkombëtare, bazuar në nenin 19.1 të Kushtetutës.*

Sipas fjalisë së parë të nenit 19.1 të Kushtetutës, "marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga **Republika e Kosovës**, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi të botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës". Në fjalinë e dytë të nenit të njëjtë thuhet se marrëveshjet në fjalë "zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji". Më zbatim të drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare nënkuptohen situatat kur normat e tyre mund të zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë pa pasur nevojë që të nxirret një ligji apo akti tjetër shtesë. Kjo ndodh vetëm në rastet kur normat e marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare kanë natyrë të vetëzbatueshme. Kanë natyrë të vetëzbatueshme ato norma që janë mjaft të qarta dhe precize ashtu që përmbajtja e tyre vetëkuptohet në çdo ambient kulturor. Nëse një normë e një marrëveshjeje apo instrumenti ndërkombëtar ka natyrë të vetekzekutueshme vendoset nga ana e organeve të brendshme të një shteti, përkatësisht nga gjykatat, agjencionet dhe institucionet tjera nacionale të zbatimit të ligjit.

Dispozitat e nenit 19.1 të Kushtetutës, si më sipër, përshkruajnë situatën kur me Kushtetutë përcaktohet statusi i një pjese të së drejtës ndërkombëtare në rendin e brendshëm juridik. Ky formulim ka një përhapje të gjerë në sistemet kushtetuese të vendeve ish-komuniste.[64] Këtu fjala është për inkorporim në sistemin e brendshëm, përmes ratifikimit, të asaj pjese të së drejtës ndërkombëtare që buron nga marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare. Këtu flitet për marrëdhënien e marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare me normat e sistemit juridik si tërësi, pra jo vetëm me normat ligjore në kuptimin teknik të fjalës por me çdo akt tjetër juridik, siç janë aktet administrative apo aktet tjera më të ulëta se ligji: çdo marrëveshje ndërkombëtare që është ratifikuar, qoftë nga parlamenti (ratifikimi kushtetues), shefi i shtetit apo qeveria bëhet pjesë e sistemit juridik kosovar dhe ka fuqi juridike më të madhe se ligji i zakonshëm dhe zëvendëson çdo ligj apo akt tjetër me fuqi më të ulët se ligji që eventualisht bie në kundërshtim me të.[65]

Kjo gjendje në **Kosovë**, megjithatë, i ka dy të meta serioze. E para, instrumentet dhe marrëveshjet kryesore që listohen ne nenin 22 të Kushtetutës dhe që kanë status të një norme kushtetuese, e barabartë me çdo normë tjetër kushtetuese, shpesh nuk kanë natyrën e **normave të vetekzekutueshme**. Kjo nënkupton se këto instrumente dhe këto marrëveshje ndërkombëtare kanë nevojë për legjislacion implementues shtesë për t'i vënë në jetë në sistemin e brendshëm juridik. Ai legjislacion shtesë implementues mund të ketë formën e amendamentit kushtetues, ligjit, dekretit ligjor si dhe formën e akteve të tjera normative më të ulëta se ligji. Natyrë vetekzekutuese nuk kanë, ta zëmë, **Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut** dhe **Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare**.

---

64 Hapja e **Kosovës** ndaj ndikimit të së drejtës ndërkombëtare dhe institucioneve e mekanizmave të saj vjen si rezultat i të kaluarës sonë tragjike në dekadat e fundit të sundimit represiv të regjimit të diktatorit serb **Sllobodan Millosheviq**, por edhe sundimit të gjatë autoritar komunist. Kjo hapje nuk është unike për Kosovën sepse një gjë e tillë ka ndodhur edhe me vendet tjera ish-komuniste në **Evropë**. Një hapje e të drejtës kushtetuese ndaj ndikimit të së drejtës ndërkombëtare, në historinë evropiane zakonisht ka ndodhur pas rrënimit të diktaturave dhe si rezultat i përmbysjeve të dhunshme të thella revolucionare. Cf. më shumë në Vladlen *Stepanovich Vereshchetin, "Some Reflections on the Relationship between International Law and National Law in the Light of New Constitutions". Në* Rein Avovič Müllerson, Malgosia Fitzmaurice, Mads Tønnesson Andenæs (eds.)., *Constitutional Reforms and International Law in Central and Eastern Europe* (The Hague: Martinus Nijhoff Publishers, 1998) fq. 6-13; Robert R. Wilson, "International Law in New National Constitutions". *The American Journal of International Law* 58, no. 2 (1964): fq. 432-436 (autori shpjegon se në shumicën e rasteve dispozitat e kushtetutave të nxjerra pas dy luftërave botërore kanë qenë në nivelin e dispozitave që inkurajojnë respektimin e të drejtës ndërkombëtare më shumë se inkorporimin e mirëfilltë të dispozitave ndërkombëtare në rendin e brendshëm juridik).

65 Cf. më shumë për këtë standard të përhapur në Gennady M. Danilenko, "The New Russian Constitution and International Law", fq. 464-465.

E meta e dytë, në vijim si më sipër, konsiston në atë se **Kosova** nuk është anëtare as e **KE** e as e **OKB**-së, kështu që, për pasojë, qytetarët e saj nuk mund të përfitojnë nga mekanizmat juridikë të mbrojtjes që ofrohen në nivel regjional dhe universal, përkatësisht nga mekanizmat për mbikëqyrjen e implementimit të instrumenteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare nga neni 22 i Kushtetutës.[66]

Për fund të këtij seksioni, sqarojmë se ekzistojnë disa dispozita kushtetuese kosovare, të cilat, në esencë, për nga fuqia e tyre juridike qëndrojnë mbi Kushtetutë. E kemi fjalën për dispozitat e saj nga neni 33.1 që flasin për **parimin e legalitetit** në rendin juridik kosovar dhe konfirmojnë vlerën absolute të normave **jus cogens** të së drejtës ndërkombëtare, duke stipuluar se nuk mund të vlejë parimi i legalitetit për veprat penale "[...] të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas të drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit".

Dispozita e nenit 33.1 si më sipër duhet parë në dritën e detyrimit kushtetues të Kosovës për respektim të së drejtës ndërkombëtare,[67] ku bën pjesë edhe cilësia e privilegjuar e normave kushtetuese që rregullojnë statusin e të drejtës zakonore ndërkombëtare në rendin kushtetues.[68]

13.3. Statusi kushtetues i *stare decisis* i GJEDNJ në praktikën e Gjykatës Kushtetuese

Kosova i takon sistemit civil të së drejtës. Në parim, vendet që i takojnë këtij sistemi, nuk e njohin formalisht konceptin **stare decisis**, përkatësisht fuqinë e vendimit të mëparshëm si burim i së drejtës, që duhet detyrimisht të merret parasysh me rastin e vendosjes në të ardhmen të rasteve të ngjashme apo identike. Kjo praktikë u takon vendeve të sistemit të së drejtës së përgjithshme. Këtë e kemi sqaruar gjerësisht më sipër. Kjo, megjithatë, nuk është kështu në praktikë: Kushtetuta në nenin e saj 53 e vë si detyrim kushtetues, për të gjitha autoritetet, që me rastin e vendosjes së rasteve që kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat e njeriut, të bazohen në vendimet e **GJEDNJ** si **stare decisis**. Ky detyrim kushtetues, sikundër u tha më sipër, vlen jo vetëm për Gjykatën Kushtetuese por për të gjitha autoritetet publike në Kosovë. Ai ka fuqinë e parimit, sipas të cilit, vendimet e **Gjykatës së Strasburgut** paraqesin një **burim formal të së drejtës** në **Kosovë**, një **stare decisis** që vlen për të gjitha autoritetet publike dhe për të gjitha rastet që kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat kushtetuese.[69]

Kjo nënkupton vënien në jetë të dy aspekteve, të cilat nuk figurojnë në përvojën e vendeve të tjera. Ato kanë të bëjnë me **precedentin në kuptim të ngushtë**, përkatësisht me vendimet meritore të **Gjykatës së Strasburgut**, dhe me **precedentin në kuptim të gjerë**, përkatësisht me mënyrën se si është interpretuar **KEDNJ** nga **Gjykata e Strasburgut**. Thënë me fjalë të tjera, në Kosovë ekziston detyrimi i të gjitha organeve e institucioneve publike për të vënë në jetë praktikën e rasteve individuale të gjykuara nga **GJEDNJ** (**res judicata**), jo vetëm ashtu siç kanë ndodhur ato raste në praktikë, por edhe ashtu siç janë

---

66 Kushtrim Istrefi and Visar Morina, "Judicial Application of International Law in Kosovo " Në Sinisa Rodin & Tamara Perisin (eds.), *Judicial Application of International Law in Southeast Europe* (Springer-Verlag Berlin Heidelberg, 2015) fq. 165-198 në fq. 169.

67 Neni 16.3 ["Epërsia e Kushtetutës"] i Kushtetutës: "Republika e Kosovës respekton të drejtën ndërkombëtare".

68 Neni 19. 2 ["Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare"] i Kushtetutës: "Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës."
Me norma juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare, shprehje e përdorur në pjesën e dytë të fjalisë së nenit 19.2 të Kushtetutës, pa asnjë dyshim, nënkuptohen normat që ndryshe cilësohen si **jus cogens**. Ky formulim kushtetues është i zakonshëm dhe gjendet edhe në kushtetutat e vendeve tjera të **Evropës**. Cf. Antonio Cassese, "Modern Constitutiutions and International Law", fq.368-393; Për qëndrim të kundërt, Cf. Kushtrim Istrefi and Visar Morina, "Judicial Application of International Law in Kosovo"), fq. 169 (ku autorët në mënyrë të gabuar besojnë se koncepti "norma juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare" është i paqartë; kjo, sipas tyre, nënkupton detyrim për **Gjykatën Kushtetuese** që në të ardhmen të bëj një saktësim të kuptimit të kësaj fjalie).

69 Në këtë kuptim, **Kosova** nuk dallon nga sistemi i të **drejtës së përgjithshme**, në të cilin për **stare decisis** flitet si për një parim Kuptimi i **stare decisis** si një parim që vlen për të gjitha autoritetet gjyqësore dhe për të gjitha rastet e ngjashme apo identike në të ardhmen ka lindur në **Angli** në shekullin e 18-të me iniciativën e njërit prej gjyqtarëve më me ndikim të kohës, **Lordi Mansfield**. Sipas tij, **stare decisis** përshkon të gjitha rastet e ngjashme apo identike në të ardhmen, duke shërbyer si shtyllë mbështetëse për arsyetimin e tyre. Cf. Stephen Waddams, "Review: Authority, Precedent, and Principle", fq.130, 132.

interpretuar nga **GJEDNJ** (**res interpretata**).[70] U mor vesh, kjo ka të bëjë çdoherë vetëm me vendimet meritore, **aktgjykimet**, jo edhe me vendimet jomeritore, **aktvendimet**. Kjo nuk është kështu gjetiu nëpër kontinentin e vjetër.

Në **Evropë**, në këtë kontekst, ekzistojnë dy sisteme, të cilat dallojnë në vartësi të asaj nëse bëhet fjalë për aktgjykimet e **GJEDNJ** ku si palë paraqitet shteti anëtar, apo për aktgjykime ku si palë paraqiten shtetet e treta. Në rastin e parë, aktgjykimi ka të bëjë me vetë shtetin anëtar dhe, si i tillë, ai duhet të përdoret si precedent, kurse në të dytin, pra kur bëhet fjalë për shtetin e tretë, aktgjykimi nuk përdoret domosdo si precedent por mund të merret parasysh me rastin e vendimmarrjes.[71] Kjo, megjithatë, nuk do të thotë se, në rastin e dytë, **res interpretata** zhduket si detyrim për vendet palë të **KEDNJ:** në rastin e dytë, vendet jo palë në aktgjykim detyrohen që me një kujdes të duhur të ndjekin interpretimin e **GJEDNJ**, pa marrë parasysh se cilin **ratio decidendi** përdorin me rastin e vendimmarrjes së tyre në nivel nacional. Po ashtu, gjyqtarët e vendeve nga rasti i parë, pra nga vendet palë në **KEDNJ**, duhet të marrin parasysh vendimet e **GJEDNJ** dhe të tregojnë dallimet në mes tyre duke dhënë çdoherë arsyet e vendimmarrjes dhe dallimeve të tilla.

Nga kjo rregull ekzistojnë disa përjashtime. Kështu, ta zëmë, në **Latvi**, gjykatat nacionale mbështeten në vendimet meritore të **GJEDNJ** dhe i përdorin ato si mjete interpretimi.[72] Në **Kosovë**, sikundër u tha, nuk ekzistojnë dallimet në mes të aktgjykimeve të rastit të parë dhe të rastit të dytë si më sipër: në të gjitha rastet, autoritetet publike kosovare, përfshirë këtu Gjykatën Kushtetuese, duhet të shërbehen me vendimet (**res judicata**) dhe interpretimet (**res interpretata**) të dhëna nga **GJEDNJ.** Kjo nënkupton që, thënë me fjalë të tjera, në Kosovë me **stare decisis** me origjinë nga **GJEDNJ** nënkuptohet jo vetëm **res judicata** ashtu siç ka ndodhur në praktikë si rast, por edhe ashtu siç është interpretuar ai rast nga ana e saj në dritën e dispozitave të **KEDNJ**. U mor vesh, këtu çdoherë flasim për rastet e vendimmarrjes meritore, jo për ato që kanë të bëjnë me aspektet tjera të gjykimeve në **Strasburg**. Kjo situatë me Kosovën, ku nuk bëhet dallimi në mes të aktgjykimeve të rastit të parë dhe të rastit të dytë vjen si pasojë e faktit të thjeshtë se nuk është anëtar i **Këshillit të Evropës** (**KE**) dhe, për pasojë, as i **GJEDNJ**.

Në praktikë, ndërkaq, vlen të theksohet se vetëm Gjykata Kushtetuese zbaton me përpikëri dhe në mënyrë konstante detyrimin kushtetues nga neni 53 i Kushtetutës, që nga dita e parë e themelimit të saj, gjë që nuk është rasti me autoritetet tjera publike kosovare, përfshirë këtu në veçanti gjyqësorin e rregullt, i cili në raste shumë të rralla mbështetet në vendimet e **Gjykatës së Strasburgut**.

Nga diskutimi i mësipërm shihet qartë se statusi kushtetues i **stare decisis** në Kosovë përcaktohet nga statusi kushtetues i lirive dhe të drejtave të njeriut në kontekstin kosovar, përfshirë këtu garantimin e statusit kushtetues të disa instrumenteve dhe marrëveshjeve kryesore regjionale dhe ndërkombëtare për liritë dhe të drejtat e njeriut. Me një status të tillë të lirive dhe të drejtave njerëzore në rendin kushtetues kosovar krejt natyrshëm figuron stimulimi detyrimi kushtetues nga neni 53 i Kushtetutës. Ka qenë krejt e pritur që në Kosovë të futet një detyrim i tillë i qartë kushtetues, nisur nga historia e fundit e Kosovës: në qershor të vitit 1999 vendi doli nga konflikti i armatosur, të cilit i paraprinë dekadat e sundimit represiv komunist të pasuara nga regjimi serb i diktatorit **Sllobodan Millosheviq**, pa asnjë përvojë në sundim të ligjit, respektim të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve dhe qeverisje demokratike. E parë në këtë dritë, dispozita e nenit 53 të Kushtetutës, në fakt, ka lehtësuar dhe lehtëson shumë punën e

---

70 Në teori dhe praktikë, me **stare decisis** të **GJEDNJ** nënkuptohet vetëm vënia në jetë e **ratio decidendi** të vendimeve meritore të kësaj gjykate. Kjo, megjithatë, nënkupton se interpretimi nacional, i bazuar në një **res judicata** shumë të ngjashëm të **Gjykatës së Strasburgut**, mund të jetë i ndryshëm nga ai. Për këtë arsye, në doktrinë është krijuar edhe termi tjetër, **res interprpretata**, për të treguar totalitetin e ndikimit të praktikës dhe teorisë së zhvilluar nga **GJEDNJ**, përkatësisht dallimin në mes të vendimit meritor si bazë për vendim (stare decisis) dhe mënyrës si është interpretuar **KEDNJ** me rastin e vendosjes meritore. Vlen të theksohet se vetë **KEDNJ** nuk ka dispozita që flasin për detyrueshmërinë të **stare decisis** dhe **res intepretata** të vendimeve të **GJEDNJ** për shtetet që nuk janë palë të **KEDNJ.** Cf. më shumë për këtë, shkrimin elokuent të Lize R. Glas, "The Boundaries to Dialogue with the European Court of Human Rights", fq. 294.300.

71 Ibid., fq. 292-298.

72 Ibid., fq. 307.

Gjykatës Kushtetuese dhe organeve të tjera publike marrë parasysh se sa e pasur është praktika gjyqësore e **Gjykatës së Starsburgut**. Kur kësaj i shtohet edhe fakti se normat kushtetuese mbi liritë dhe të drejtat e njeriut janë të matshme, në pjesën e tyre dërrmuese, me standardet regjionale dhe ndërkombëtare, konstatimi si më sipër del i drejtë: si në të drejtën materiale ashtu dhe në praktikën gjyqësore, Kosova në tërësi mbështetet në **stare decisis** me origjinë nga **GJEDNJ**.

Përtej këtij detyrimi kushtetues në sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut, **Gjykata Kushtetuese** ka zbatuar dhe zbaton doktrinën **stare decisis** në mënyrë gjithëpërfshirëse edhe në gjykimet që kanë të bëjnë me kontrollin abstrakt të normave juridike por edhe në gjykime të tjera. Në këto raste, vendimet e mëhershme që shërbejnë si **stare decisis** kryesisht i referohen gjykatave të huaja dhe përvojave të vendeve tjera në gjyqësinë kushtetuese në përgjithësi, si dhe punës dhe përvojave të **Komisionit të Venecias** dhe trupave të tij, siç është **Forumi i Venecias**, të cilat kanë të bëjnë me qëndrimet e tyre lidhur me atë që kaherë është cilësuar nga ana e Komisionit si një **trashëgimi e përbashkët kushtetuese** (**common contitutional heritage**).[73] Në këto raste, të cilat më hollësisht jepen në vazhdim të këtij seksioni, **stare decisis** ka kuptimin e një **burim i butë** i së drejtës. Kjo për arsye të faktit se **Gjykata Kushtetuese** nuk ka detyrim për të përdorur si **ratio decidendi** argumentet e organeve vendimmarrëse të vendeve të tjera, të cilat mund të jenë gjykata kushtetuese, organe apo forume të tjera ndërqeveritare të karakterit regjional apo ndërkombëtar, siç është rasti, ta zëmë, me **Komisionin e Venecias** dhe trupat e tij.

Gjykata Kushtetuese nuk ka detyrim të ruajë **stare decisis** që ka e krijuar nga vetë ajo. Vlen të theksohet se, megjithatë, ndryshimi i praktikës gjyqësore vetanake duhet të shoqërohet me një analizë dhe arsyetim të thellë, bindës dhe të argumentuar mirë duke iu referuar në mënyrë ekskluzive çështjeve apo aspekteve meritore të rastit, jo atyre procedurale që kanë natyrë jomeritore. Kjo është kështu sepse vetëm në vendimmarrjen meritore Gjykata futet në brendinë e rastit, në anën e faktike dhe juridike të formimit të tij, me qëllim të dhënies së përgjigjes përfundimtare lidhur me rastin dhe mosmarrëveshjen konkrete kushtetuese. Thënë me fjalë tjera, Gjykata vetëm me aktgjykim mund të krijojë dhe të prishë precedentet e mëparshme, gjithnjë duke dhënë arsye e argumente të stërholluara për devijim nga precedenti i mëhershëm. Me aktvendim, përkatësisht me vendim jomeritor, precedenti as nuk krijohet e as nuk mund të prishet. Kjo për shkak se me te, Gjykata nuk hyn në brendi të anës faktike dhe juridike të formimit të rastit apo mosmarrëveshjes kushtetuese sepse ekzistojnë pengesa juridike të natyrës procedurale që kanë të bëjnë me juridiksionin dhe palët, objektin e gjykimit dhe me vetë Gjykatën. Këto ndryshe quhen **prezumimet proceduriale** për pranueshmërinë e kërkesës.

Shikuar nga këndvështrimi si më sipër, qartë vërehet se zbatimi i precedentit të **Gjykatës së Strasburgut** nga ana e autoriteteve publike kosovare nuk bën pjesë në kategorinë e zbatimit të së drejtës së huaj. Ai përfshin si kuptimin e ngushtë (**res judicata** si një **stare decisis**) ashtu edhe kuptimin e tij të gjerë (**res interpretationis** si një **stare decisis**). Në kontekstin e gjyqësisë kushtetuese, kjo nënkupton që Gjykata Kushtetuese përdorë precedentet e **Strasburgut** jo për ilustrim, por si pjesë përbërëse e aparatit të vet mendor (intelektual) argumentues për vendosjen meritore të rasteve dhe mosmarrëveshjeve të ndryshme kushtetuese të parashtruara pranë saj për shqyrtim dhe vendosje në mënyrë ligjërisht të rregullt. Kjo është kështu për dy arsye:

- e para, këtu bëhet fjalë për vënien në jetë të një detyrimi kushtetues për të zbatuar **KEDNJ**, detyrim që është i mishëruar në dispozitat e nenit 53 të Kushtetutës së vitit 2008;[74] dhe,

[73] Me këtë term nënkuptohet sundimi i ligjit, liritë dhe të drejtat e njeriut dhe demokracia. Si rezultat i punës dhe përpjekjeve të **Gjykatës së Strasburgut** dhe të **Komisionit të Venecias**, të cilat kanë operacionalizuar këta tre përbërës të trashëgimisë së përbashkët kushtetuese, kanë përfituar krejt vendet ish-komuniste, disa nga vendet e **Afrikës së Veriut** (**Tunizia** etj.), por edhe disa nga vendet tjera të demokracive të vjetra evropiane (**Islanda, Belgjika** etj). Cf. më shumë për kuptimin e trashëgimisë së përbashkët kushtetuese dhe përbërësit e saj, në Maartje de Visser, "A Critical Assessment of the Role of the Venice Commission in Processes of Domestic Constitutional Reform". *The American Journal of Comparative Law* Vol. 63 Issue 4 (October 2015) fq. 963-1008 në fq. 972, 999-1004.

[74] Kushtrim Istrefi and Visar Morina, "Judicial Application of International Law in Kosovo", fq. 170.

- e dyta, si pjesë e kësaj dispozite është edhe detyrimi sipas së cilit çdo gjë që ka të bëjë me liritë dhe të drejtat e njeriut duhet të interpretohet konform praktikës gjyqësore dhe interpretimit të **GJEDNJ**.

Në praktikën gjyqësore të **GJEDNJ**, interpretimi i **KEDNJ** nuk është autoreferencial. Ai bazohet, përveç në praktikën e mëhershme gjyqësore të vetë **GJEDNJ**, edhe në burime tjera të së drejtës. Ato burime tjera të së drejtës jo çdoherë janë burime të forta: jo rrallë, aty hasim në vendime, pjesa arsyetuese e pjesës së verdiktit të tyre shërbehet gjerësisht me burime të së **drejtës së butë**, siç janë mendimet dhe qëndrimet e **Komisionit të Venecias** dhe organeve e trupave të tjerë në nivel regjional dhe ndërkombëtar. Deri në gusht të vitit 2016, rreth 100 aktgjykime dhe vendime të **GJEDNJ** iu janë referuar dokumenteve të **Komisionit të Venecias**. Rastet e para në të cilat **GJEDNJ** ka filluar t'iu referohet Komisionit të Venecias janë vendosur në vitin 2001: në vendimin e vet në rastin **Banković and others v. Belgium and others** të datës 12 dhjetor 2001,[75] Komisioni iu ka referuar **Raportit mbi trajtimin preferencial të pakicave kombëtare nga shtetet e tyre amë** (CDL-INF(2001)019), kurse në rastin **Hirst v. the United Kingdom** të datës 30 mars 2004**,**[76] referimi ka pasur të bëjë me **Kodin e praktikave të mira në çështjet elektorale** (CDL-AD(2002)023rev-e).

Që nga kjo kohë, referenca në dokumentet e Komisionit nga ana e **GJEDNJ** është bërë në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike. Në periudhën e viteve 2010 – 2017 më shumë se 50 aktgjykime të **GJEDNJ** iu kanë referuar dokumenteve të tij. Këto referime kanë të bëjnë me mendimet ose studimet e Komisionit. Si të tilla, ato mund të ndahen në tri grupe: në të parin hyjnë arsyetimet e dhëna në **ratio decidendi** të aktgjykimeve të **GJEDNJ,** duke përdorur ***raison d'être*** të mendimeve dhe studimeve të Komisionit; në grupin e dytë hyjnë referimet e mendimeve apo studimeve të Komisionit të bëra nga ana e gjyqtarëve në mendimet e tyre mospajtuese ose konkurruese; dhe, së fundi, në grupin e tretë bëjnë pjesë ato referime në dokumentet e Komisioni që shtjellojnë, përkatësisht kanë për objekt pjesët relevante të së drejtës ndërkombëtare dhe praktikës së saj. Jo vetëm kaq! **GJEDNJ** ka mbështetur vendimmarrjen e saj jo vetëm në mendimet dhe studimet e Komisionit, por edhe ka kërkuar nga ai në mënyrë të drejtpërdrejtë që të bëjë **amiucus curiae** për nevojat e saj.[77]

Në vijim të diskutimit si më sipër, në rastin e gjyqësisë kushtetuese kosovare, që përbën objekt trajtimi në këtë kapitull dhe në kapitujt në vijim, **stare decisis** përfshinë jo vetëm lëmin e lirive dhe të drejtave të njeriut sipas standardeve të **Gjykatës së Strasburgut**: ekzistojnë edhe burime të tjera të huaja, përfshirë këtu burimet e të **drejtës së butë**, të cilat kanë gjetur vend meritor në **ratio decidenti** të **Gjykatës Kushtetuese**. Kjo nënkupton se gjyqësia kushtetuese kosovare thithë praktikën e interpretimit të **KEDNJ** përmes **stare decisis** të prodhuar në **GJEDNJ**, ku përfshihet e **drejta e butë** e **Komisionit të Venecias** dhe burimet të tjera të së drejtës ndërkombëtare në lëmin e lirive dhe të drejtave të njeriut. Kjo është kështu për dy arsye: *e para*, sepse, siç u pa, një të drejtë të tillë të butë e venë në jetë edhe vetë **Gjykata e Strasburgut** kjo nënkupton se kur bëhet fjalë për vendimet e saj që kanë për bazë burimet e buta të së drejtës, një vendim i tillë në **Kosovë** ka fuqinë e detyrimit kushtetues **per constitutionem** që buron nga neni 53 i Kushtetutës; dhe, *e dyta*, si një gjykatë e re, **Gjykata Kushtetuese** ka pasur dhe ka nevojë të vazhdueshme për të konfirmuar, ndryshuar apo plotësuar praktikën e vetë gjyqësore.[78] Ekzistimi i kësaj nevoje dëshmohet në veçanti nga përvoja e vendeve tjera demokratike që për herë të parë kanë instaluar gjyqësinë kushtetuese.

---

75 ECtHR: **Banković and others v. Belgium and others**. (Application no. 52297/99, § 60, Judgement of 12 December 2001).

76 ECtHR: **Hirst v. the United Kingdom** (Application no. 74025/01, Judgement of 6 October 2006).

77 Të gjitha të dhënat janë marrë nga veb faqja zyrtare e **Komisionit të Venecias**: https://www.venice.coe.int/Web Forms/pages/?p=02_references&lang=FR#ECHR (ku janë dhënë të gjitha referimet në dokumentet dhe punimet e **Komisionit të Venecias** që bëhen nga ana e organeve e organizatave të ndryshme nëpër botë).

78 Praktika gjyqësore dëshmon se në rastet kur gjyqësia kushtetuese në nivel nacional përdor të drejtën e huaj, një gjë e tillë çdoherë bëhet me qëllim të konfirmimit, ndryshimit apo plotësimit të qëndrimeve të dhëna në verdikt. Cf. më shumë në studimin e thellë të kësaj problematike nga aspekti krahasimor të Vicky C. Jackson, Constitutional Engagement in a Transnational Era (Oxford University Press: Oxford, 2010); Lidhur me përvojën e ngjashme të gjyqtarëve të **Holandës** në çështjet kushtetuese, në vendin ku epërsia (supremacia) e të drejtës ndërkombëtare është gati absolute, Cf. më shumë në shkrimin e Lize R. Glas, "The Boundaries to Dialogue with the European Court of Human Rights", fq. 308.

Në vijim të kontekstit si më sipër, krahas **stare decisis** të **Gjykatës së Strasburgut** ekzistojnë edhe burimet tjera të huaja, përfshirë këtu burimet e natyrës të së **drejtës së butë**, të cilat kanë gjetur dhe gjejnë vend të spikatur në **ratio decidenti** të Gjykatës Kushtetuese.[79] Për më tepër, ka raste kur një **burim i butë** përmes miratimit të tij nga **Kuvendi i Kosovës,** është kthyer në të drejtë të fortë, përkatësisht në një burim formal të së drejtës me rëndësi parësore.[80]

Ndër burimet e së drejtës që listohen në praktikën gjyqësore të gjykatave të huaja kushtetuese hyn edhe shkenca juridike. Lidhur me këtë, në literaturë është vërejtur se vendet e ndryshme dallojnë ndërmjet veti sa i përket raportit të gjyqtarëve kushtetues me literaturën juridike dhe përdorimin e saj në arsyetimin argumentues të verdiktit. Dallimi nuk mbaron me kaq: ai shpërfaqet edhe në metodat, konceptet dhe doktrinat që janë me origjinë nga shkencat juridike dhe që përdoren nga

---

[79] Cf. më shumë lidhur me këtë në rastet si vijon:
Rasti KI 56/09. Aktgjykim. Parashtruesit: Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë . Datë: 22 dhjetor 2010. Nr. Ref.: RK 77/10. Paragrafët 62-64 (në paragrafin 62, Gjykata citon në mbështetje të arsyetimit të saj një dokument të OKB-së, **Deklaratën e Rios për Mjedis dhe Zhvillim,** miratuar në vitin 1992 në **Konferencën e OKB-së për Mjedis dhe Zhvillim;** ky dokument ndërkombëtar, që përbën një të drejtë të **drejtë e butë** edhe për vetë **OKB**-në, parashikon disa standarde të larta lidhur me përgjegjësinë e shtetasve për avancimin dhe ruajtjen e ambientit, por edhe përgjegjësinë e shtetit për të ndarë informacionin rreth mjedisit me shtetasit e vet në mënyrë që të sigurohet një pjesëmarrje sa më e gjerë e shtetasve në vendimmarrjen rreth problemeve të mjedisit jetësor; në paragrafin në vijim, Gjykata tregon historinë e vënies në jetë nga ana e **Komisionit Ekonomik për Evropë të OKB**-së të parimit nr. 10 të **Deklaratës së Rios**, që ka të bëjë me sigurimin e pjesëmarrjes së shtetasve në vendimmarrjen rreth ambientit në të gjitha fazat e saj; në fund, në paragrafin 64 citohet një dokument i **Asamblesë Parlamentare të KE**, Rekomandimi 1614 për mjedis dhe të drejtat e njeriut, që po ashtu përbën një të **drejtë të butë** për vetë shtetet anëtare të KE; në këtë rekomandim bëhet fjalë për të drejtën e njeriut për mjedis të shëndosh dhe për detyrimin e shtetit dhe shoqërisë për të siguruar një pjesëmarrje sa më të gjerë dhe transparente të individit në çështjet e mbrojtjes dhe avancimit të mjedisit jetësor);
Rasti KO 80/10. Aktgjykim. Parashtrues: Kërkesa e Presidentit të Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së tij Dr. Fatmir Sejdiu, për sqarim të kompetencave në rastin e kryetarit të Rahovecit, z. Qazim Qeska. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtinë. Datë: 7 tetor 2010 . Ref. nr. AGJ 46110 . Paragrafet: 29, 32 & 41 (ku Gjykata flet për **Kartën Evropiane për Vetëqeverisje** Lokale si për një dokument fundamental që garanton autonominë në nivel lokal, mbikëqyrjen administrative të punës së organeve lokale nga pushteti qëndror dhe, në fund, për sendërtimin e parimit të demokracisë në nivel lokal);
Rasti KO 97/12. Aktgjykim. Parashtrues: Avokati i Popullit Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve: 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116, të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtinë. Datë: 12 prill 2013 . Nr. ref.: AGJ 403/13 . Paragrafët: 136-137 (në paragrafin 136 Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës pohon se nenet e kontestuara të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare janë në kundërshtim me **Rekomandimin CM/Rec. 14** (2007) të **Komitetit të Ministrave të KE** për statusin ligjor të organizatave joqeveritare në **Evropë**, miratuar më 10 tetor 2007; në paragrafin në vijim, Gjykata thekson se ky rekomandim nuk është një instrument detyrues juridik, por vetëm një rekomandim, i cili, megjithatë, përmban parimet universale demokratike, të cilave duhet t'i përmbahen OJQ-të në Kosovë, parime të cilat janë respektuar dhe janë zbatuar gjerësisht në shoqëritë demokratike);
Rasti KO 13/15 . Aktgjykim. Vlerësim i një amendamenti të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të propozuar nga pesëdhjetë e pesë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe të referuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 6 shkurt 2015 me shkresën nr. 05-259/DO-179. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë. Datë: 16 mars 2015. Nr. ref.: AGJ 782/15. Paragrafët: 45-52, 58-59 (në këta paragrafë, Gjykata ka dhënë shpjegimet lidhur me zgjidhjet krahasuese sa i përket garancive kushtetuese kosovare të barazisë gjinore duke vërtetuar se ato janë në linjë me shumë kushtetuta të vendeve demokratike dhe me instrumente e rekomandime ndërkombëtare; në fillim jepen sqarimet rreth zgjidhjeve kushtetuese të vendeve si **Bullgaria, *Çekia, Franca,* Qipro, Letonia, Sllovakia** dhe **Sllovenia**, për të pasqyruar qëndrimin e një të **drejte të butë** të **Komitetit të Ministrave KE**, **Rekomandimit Rec. (2003)3 për Pjesëmarrjen e barabartë të femrave dhe meshkujve në sjelljen e vendimeve politike dhe publike,** miratuar nga Komiteti i Ministrave, më 12 mars 2003, në mbledhjen e 831-të të zëvendësministrave.

[80] Cf. *Rasti KO 26/15. Aktgjykim. Vlerësim i amendamentit të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe referuar më 9 mars 2015 nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, me Shkresën nr. 05-433/DO-318*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë. Datë: 15 prill 2015. Nr. ref.: AGJ 788/15. Paragrafët: 50-51 (në këto dy paragrafë Gjykata vëren se në amendamentin e propozuar parashikohet themelimi i dhomave të specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të Specializuar në kuadër të sistemit të drejtësisë të Republikës së Kosovës si një kërkesë për Republikën e Kosovës që ajo të përmbushë obligimet e saj ndërkombëtare; këto obligime ndërkombëtare burojnë nga **Raporti i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës** (**Dokumenti 12462**), i 7 janarit 2011, që përmbledh një numër të pretendimeve penale shumë specifike dhe që rekomandon që ato të hetohen dhe të ndiqen penalisht; këto obligime u inkorporuan në kornizën juridike të Republikës së Kosovës nëpërmjet miratimit të **Ligjit nr. 04/L-274 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë,** nga shumica e dy të tretave të Kuvendit; sikundër shihet, në këtë rast një e **drejtë e butë** është shndërruar në të drejtë të fortë dhe në detyrim ndërkombëtar përmes miratimit me ligj nga pala kosovare të raportit si më sipër të **Asamblesë Parlamentare të KE**, që sot njihet me emrin **Dokumenti 12462**).

gjyqtarët kushtetues me rastin e vendimmarrjes së tyre. Në këtë kontekst dallohen disa lloje të praktikave nacionale.

Në parim, në të shumtën e vendeve, citimi i burimeve me origjinë nga literatura e shkencave juridike, përkatësisht operimi nga ana e gjyqtarëve kushtetues me koncepte e metoda të shkencës juridike është shumë i rrallë. Këtë e konstaton praktika e rrallë në disa vende. Ky përbën grupin e parë të shteteve.[81] Në grupin e dytë hyjnë ato vende ku citimi i burimeve me origjinë nga shkenca juridike është tërësisht i ndaluar. Një gjë e tillë ndodhë qoftë për shkak se teksti kushtetues ndalon në mënyrë shprehimore përdorimin e literaturës shkencore në vendimmarrje apo për arsye se vetë gjykata nuk përdor një burim të tillë si bazë për të mbështetur argumentet e veta me rastin e vendosjes.[82] Në grupin e tretë pasojnë vendet

---

81 Eoin Carolan, "The Supreme Court of Ireland". Në András Jakab, Arthur Dyevre and Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* (Cambridge University Press: Cambridge, 2017), fq. 438-470, në fq. 447-449 (autori tregon se shumë rrallë citohen dijetarët e drejtësisë në arsyetimin argumnetativ të vendimeve të kësaj gjykate; edhe në ato pak raste kur citohen, fjala është për citime të teksteve akademike, jo të artikujve nga revistat akademike); Tamas Gyorfi, "The Supreme Court (House of Lords) of the United Kingdom". Në András Jakab, Arthur Dyevre and Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq, 679-722, në fq. 691-692 (në raport me gjyqtarët dhe ligjvënësit, dijetarët e drejtësisë në këtë vend luajnë një rol shumë margjinal; duke iu referuar dy autorëve tjerë, **Zenon Bankowski** dhe **Neil MacCormick**, autori thekson se nga vitit 1991, ekziston një tendencë në rritje nga ane e Gjykatës Supreme për të cituar artikujt e revistave prestigjioze akademike, monografitë dhe burimet tjera të literaturës); Howard Scweber and Jennifer L. Brookhart, "The Supreme Court of the United States". Në András Jakab, Arthur Dyevre and Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 723-760, në fq. 732-733 (autori thekson se në fillim, Gjykata Supreme i ka kushtuar një rëndësi të madhe burimeve të literaturës juridike me rastin e vendimmarrjes; për këtë citohet si shembull një vendim i vitit tanimë të largët 1873, i njohur si **Slaughterhouse Cases**; kjo gjendje ka ndryshuar viteve të fundit, ku Gjykata rrallë e më rrallë i ka kushtuar vëmendje literaturës juridike dhe shkrimeve akademike); Hugo Cyr and Monica Popescu, "The Supreme Court of Canada". András Jakab, Arthur Dyevre and Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 179-170 (autori shpjegon se dijetarët e drejtësisë synojnë të qëndrojnë sa më larg vendimeve të Gjykatës Supreme të Kanadasë; autori thekson së, përkundër kësaj, gjykatat kanadeze, përfshirë Gjykatën Supreme, nuk janë jashtë ndikimit të doktrinës; në lidhje me këtë, autori thekson se libri i Peter Hogg "E drejta kushtetuese e Kanadasë", si dhe shkrimi i Peter Hogg dhe Allison A. Bushell me titull "Dialogu i Kartës në mes të gjykatave dhe legjislaturës" përbëjnë raste të shpeshta të citimit nga ana e Gjykatës Supreme të Kanadasë; ky citim nganjëherë ka të bëjë me miratimin e tezave dhe pikëpamjeve të këtyre autorëve dhe të autorëve tjerë, e nganjëherë me refuzimin e tyre); Wen-Chen Chang, "The Constitutional Court of Taiwan". Në András Jakab, Arthur Dyevre and Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning,* fq. 641-678, në fq. 648-649 (autori në fillim konstaton se në këtë vend ka qenë i madh ndikimi i të drejtës së huaj dhe të drejtës krahasuese, në ndërkohë që ky nuk ka qenë rasti në vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese; arsyeja për këtë, sipas autorit, gjendet në faktin se gjyqtarët e edukuar nën ndikimin e fuqishëm të së drejtës së huaj dhe të drejtës komparative, nuk shohin të domosdoshme që këtë të theksojnë në mënyrë shprehimore në vendimet e tyre; në vend të kësaj, ata asimilojnë këtë ndikim në vendimet e marra, pa u vërejtur një ndikim i tillë; në fund, konstaton autori, të rralla janë rastet kur Gjykata në mënyrë shprehimore citon burime e huaja të literaturës në mbështetje të arsyetimit të vet argumentativ).

82 András Jakab and Johanna Fröhlich, "The Constitutional Court of Hungary". Në András Jakab, Arthur Dyevre and GiulioItzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, 394-435, në fq. 406 (në **Hungari,** dijetarët e drejtësisë nuk kanë qenë asnjëherë të cituar në vendimet e **Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë**; për më tepër, autori nga tregon se teoricientët hungarez të drejtësisë kanë qenë dhe janë shumë kritik dhe të ashpër në vlerësimet e tyre për Gjykatën Kushtetuese; i vetmi ndikim që kanë mund të kenë dijetarët e drejtësisë në praktikën gjyqësore të kësaj gjykate, sipas autorit, ka mund të jetë ndikimi i tërthortë si pasojë e faktit se gjyqtarët të saj kanë qenë jo rrallë herë edhe juristë nga jeta akademike); Tania Groppo and Irene Spingo, "The Constitutional Court of Italy". Në Në András Jakab, Arthur Dyevre and Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 516-559, në fq.525-528 & 547-548 (pasi konstaton se në të drejtën italiane, përfshirë të drejtën dhe gjyqësinë kushtetuese të këtij vendi, në mënyrë shprehimore nuk lejohet citimi i dijetarëve të drejtësisë, autori tregon se, megjithatë, në pjesën e arsyetimit argumentativ aksiomatik të **Gjykatës Kushtetuese të Italisë** ekzistojnë shenjat e mbështetjes në literaturën e të drejtës kushtetuese); Janneke Gerards, "The European Court of Human Rights". Në András Jakab, Arthur Dyevre and Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 237-276 në fq. 254-255 (autori na bën me dije se në **Gjykatën e Strasburgut** kurrë nuk ndodhë që të figurojë si citim një autor apo literaturë nga bota akademike; kjo, megjithatë, nuk do të thotë se gjyqtarët e **Strasburgut** nuk mbështeten fuqishëm dhe nuk përdorin literaturën e autorëve të jashtëm me ndikim në diskursin mbi të drejtat dhe liritë e njeriut dhe në gjyqësinë kushtetuese në përgjithësi; kjo, sikundër shihet, është shumë situatë e ngjashme me praktikën gjyqësore të **Gjykatës Kushtetuese** në **Kosovë**); Marian Ahumada Ruiz, "The Spanish Constitutional Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre and Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 604-640, në fq. 617-619 (autori në tregon se në vitet e para pas themelimit, **Gjykata Kushtetuese e Spanjës** ka qenë e dominuar nga profesorët e së drejtës; kanë qenë profesorët e së drejtës kushtetuese ai që ka caktuar tonin e debatit për çështjet kushtetuese dhe ka kontribuar në konstitucionalizmin e tërë rendin juridik spanjoll; kjo nuk d.m.th. se vendimet e kësaj gjykate janë mbështetur në autoritetet akademike në lëmin e drejtësisë; kjo gjendje ka ndryshuar viteve të fundit, ku Gjykata më nuk është në qendër të vëmendjes së publikut; në fakt, tani vendimet e Gjykatës më shumë janë të ekspozuara ndaj kritikës profesionale dhe shkencore se diku; sidoqoftë, mungon citimi apo përdorimi i literaturës juridike shkencore apo profesionale në vendimmarrjen e kësaj gjykate); Giulio Itzcovich, "The European Court of Justice". Në András Jakab, Arthur Dyevre and Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 277-322 në fq. 286-288 (nga shtjellimet e këtij autori del qartë se nuk ka pasur ndonjë diskutim apo rast që **Gjykata Evropiane e Drejtësisë** të ketë përdorur apo të jetë bazuar, shprehimisht apo në mënyrë të heshtur, në ndonjë autor apo punim të jashtëm; autori tregon se deri në arritjen e **Marrëveshjes së Mastriht**-it në vitin 1992, shkenca juridike ka qenë shumë dashamirëse dhe përkrahëse e vendimeve të kësaj gjykate; pas këtij viti, gjendja ka ndryshuar rrënjësisht ashtu që sot nga katër anët e shkencës juridike dhe shkencave politike vijnë kritikat e ashpra në adresë të kësaj gjykate).

ku përdorimi i literaturës së huaj lejohet vetëm në mënyrë të tërthortë dhe joshprehimore.[83] Në spektrin e dallimeve lidhur me përdorimin e shkencës juridike si burim të së drejtës, vlen të përmenden vendet që paraqesin grupin e katërt ku jo vetëm që lejohet dhe paraqitet si diçka e zakonshme praktika e përdorimit të shkencës juridike, por ajo përbën një bazë për mbështetje të arsyetimit argumentativ të verdiktit të gjykatës që sforcohet dhe inkurajohet në një masë tejet të madhe.[84]

Kosova i takon grupit të vendeve ku **Gjykata Kushtetuese** në vendimmarrjen e saj ka përdorur kategoritë tjera si burime të së drejtës, por jo edhe literaturën shkencore juridike. Deri më sot, me dy përjashtime që mund të vërehen lehtë,[85] kjo

---

83 *Conrado Hübner Mendes*, "The *Supreme Federal Tribunal of Brazil"*. Në András Jakab, Arthur Dyevre and Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning,* fq.115-153, në 133-132 (autori argumentin se diskursi kushtetues i **Tribunalit Suprem Federal** formësohet në të shumtën e kohës duke u bazuar në tekstet dhe kanonet e arsyetimit të importuara nga autorët me ndikim nga **Evropa** dhe **SHBA;** qëndrimet e këtyre autorëve nga dy anët e Atlantikut, në Brazik më pastaj kthehen në idom lokale, siç thot autori, pa marrë parasysh sa iu përshtaten vendimeve të Tribunalit); Zdeněk Kühn, "The Constitutional Court of the Czech Republic". Në András Jakab, Arthur Dyevre and Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning,* fq. 199-236, në fq 210-211 (autori na shpjegon se si në këtë vend ekziston një traditë e pasur e bashkëpunimit në mes të teorisë dhe praktikës në lëmin e drejtësisë, përfshirë këtu gjyqësinë kushtetuese; në vijim të kësaj, autori vëren se **Gjykata Kushtetuese e *Republikës së*** Çekis***ë*** merr shumë seriozisht komentet dhe kritikat e bëra nga bota akademike dhe i adreson ato në aktgjykimet e veta); Arthur Dyevre, "The French Constitutional Council". Në András Jakab, Arthur Dyevre and Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning,* fq. 323- 355, në fq. 330-334 (autori nënvizon se në **Francë** ekziston një trend tjetër sa i përket marrëdhënies në mes të teorisë dhe praktikës: në Francë, dijetarët e drejtësisë me zell të madh shtjellojnë dhe përligjësojnë vendimet e **Këshillit Kushtetues,** duke i bërë lëvdata e përgëzime për zbulimin e të vërtetës së fshehur në tekstin kushtetues; në veçanti rol të madh në këtë drejtim ka luajtur juristi i mirënjohur francez **Louis Favoreu**, por edhe disa autorë tjetër francez që kanë komentuar dhe komentojnë vendimet e Këshillit; me reformat e vitit 2010, që i japin Këshillit të drejtën për kontroll konkret apo incidental të kushtetutshmërisë së ligjeve, gjendja sikur ka ndryshuar në kuptim të asaj që tani e tutje kërkohet ekspertizë në shtjellimin e praktikën gjyqësore të Këshillit).

84 Michaela Hailbronner and Stefan Martini, "The German Federal Comnstitutional Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre and Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning,* fq. 356-393. në fq. 366 (autori na tregon se marrëdhënia e praktikës gjyqësore me teorinë kushtetuese gjermane është aq e ngushtë sa **Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë** shumë shpesh i referohet dhe i miraton doktrinat kushtetuese të zhvilluara nga teoria; ky fakt interesant, sipas autorit, buron nga rrethana historike e dominimit të qasjeve dogmatike në praktikën gjyqësore gjermane; deri në **Luftën e Dytë Botërore**, në **Gjermani** ka dominuar dogmatizmi juridik: gjatë shekullit XIX dhe në kohën e **Gjermanisë së Vajmarit** juristët e praktikës kanë dominuar të drejtën publike gjermane; kjo gjendje ka ndryshuar rrënjësisht që nga vitit 1945: tani dijetarët e drejtësisë diktojnë tempon dhe përmbajtjen e të drejtës publikë gjermane; ky dominim është aq i madh sa një jurist i njohur gjerman, **Berndard Schlink**, këtë gjendje e ka cilësuar si "pozitivizëm i Gjykatës Kushtetuese"); Christa Rautenbach and Lourens Du Plessis, "The Constitutional Court of South Africa". Në András Jakab, Arthur Dyevre and Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning,* fq. 560-603, në fq. 576 (autori thekson se gjyqtarët e **Gjykatës Kushtetuese të Afrikës së Jugut** në përgjithësi i pranojnë autoritetet teorike që i përdorin gjatë punës së tyre; puna e shkruar akademikëve të drejtësisë merret parasysh dhe vlerësohet në bazë të meritave individuale të secilit rast ku mund të përdoret puna e tillë akademike); Cheryl Saunders and Adrienne Stone, "The Hight Court of Australia". Në András Jakab, Arthur Dyevre and Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning,* fq. 36-74, në fq. 40-41 (autori tregon se **Gjykata e Lartë e Australisë** përdor si burim të së drejtës autorët e njohur të së drejtës, në veçanti të së drejtës kushtetuese; jo vetëm Gjykata e Lartë, por vetë palët përdorim librat dhe shkrimet e autorëve me ndikim në shkencën juridike dhe shkencat politike për të argumentuar kërkesat e tyre; përveç përdorimit shprehimor të burimeve shkencore, autori thekson së në mënyrë implicite shkrimet akademike janë pjesë përbërse e klimës së përgjithshme të vendimmarrjes në Gjykatën e Lartë); Konrad Lachmayer, "The Austrian Constitutional Court". ". Në András Jakab, Arthur Dyevre and Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning,* fq. 75-114, në fq. 87-88 (autori thekson se ndërveprimi në mes të **Gjykatës Kushtetuese të Austrisë** dhe dijetarëve të shkencave juridike ka qenë një pjesë e rëndësishme e zhvillimit të së drejtës kushtetues austriake; shumica e aktgjykimeve të Gjykatës përmbajnë referenca të autorëve me ndikim në **Austri**, të dijetarëve austriakë të së drejtës; përveç kësaj, anëtarët e post-doktoratës ndihmojnë Gjykatën në punën e saj, të cilët rekrutohen nga fakultetet juridike të vendit); Suzie Navot, "The Israeli Supreme Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre and Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 471-515, në fq. 480-481 (ndikimi i teoricientëve të drejtësisë në këtë vend është mjaft i madh, aq sa në disa raste ne vendim publiku udhëzohet si në një artikull akademik se çfarë shkrimesh akademike shtesë mund të lexojnë lidhur me rastin e vendosur; autori na tregon se gjyqtarët zakonisht nuk janë akademik, mirëpo ndikimi i akademikëve në arsyetimin argumentativ është mjaft të theksuar, kryesisht me qëllim të forcimit të argumentit themelor të verdiktit të **Gjykatës Supreme të Izraelit**).

85 E kemi fjalën për rastet si vijon:
Rasti KO 95/13. Aktgjykim. Parashtrues: Visar Ymeri dhe 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit, Nr. 04/L-199, për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të Planit të zbatimit për këtë marrëveshje. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë. Datë: 9 shtator 2013 . Nr. ref.: AGJ 469/13 (ku Gjykata në paragrafët 48-52 ka konstatuar ndarjen e praktikave kushtetuese sipas rolit dhe pozitës që marrëveshjet dhe traktatet ndërkombëtare zënë në të drejtën e brendshme; ky klasifikim doktrinar është marrë nga libri Anthony Aust, *Modern Treaty Law in Practice*, Cambridge University Press: Cambridge, 2000, fq. 143-161);
Rasti KO 79/18. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Presidenti i Republikës së Kosovës. Kërkesë për interpretim të nenit 139. paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtinë. Datë: 3 dhjetor 2018. Nr. ref.: RK 1294/18 (ku Gjykata në paragrafin 69 ka përdorur shprehje doktrinare nga *Komentari i Kushtetutës së Kosovës* i autorëve **Enver Hasani** dhe **Ivan Cukallovic**, botim i GIZ, Prishtinë, 2013, fq. 400-402; në këto faqe, autori i parë i këtij libri shtjellon kuptimin e

gjykatë me zell të madh ka përdorur kategoritë tjera të së drejtës së huaj si burime në mbështetje të mbështetje të vendimmarrjes së saj.

Në këtë kontekst ekzistojnë tri kategori të burimeve të së drejtës së huaj, të cilat i ka vënë në punë **Gjykata Kushtetuese e Kosovës**: në grupin e parë hyn praktika e gjykatave të huaja kushtetuese dhe zgjidhjet e huaja kushtetuese e ligjore (në disa raste, dy këto burime përdoren në të njëjtën kohë në pjesën arsyetuese me qëllim të argumentimit të verdiktit përfundimtar të Gjykatës);[86] në grupin e dytë hyjnë mendimet dhe vendimet e **Komisionit**

gjerë dhe të ngushtë të termit "çështje kushtetuese", e cila mund të ngritet në **Gjykatën Kushtetuese** në bazë të nenit 84.9 ["Kompetencat e Presidentit"] të Kushtetutës, shprehje që janë përdorur në shtjellimet e Gjykatës në aktvendimin si më sipër).
Kjo gjendje, përkatësisht situata në të cilën Gjykata zakonisht nuk i referohet shkencës juridike si burim rrjedh si rezultat i faktit se, njëjët si në vendet tjera, në **Kosovë** kanë munguar dhe mungojnë autoritetet relevante me kredenciale të besueshme akademike dhe shkencore, shkrimet e të cilëve do të mund të përdoreshin në arsyetimin e vendimeve të **Gjykatës Kushtetuese.**

86 Lidhur me këtë grup, shiko rastet si vijon:
Rasti Ko 119/10. Aktgjykim. Parashtrues: Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 14 paragrafit 1.6, nenit 22, nenit 24, nenit 25 dhe nenit 27 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, Nr. 03/L111, të 4 qershorit 2010. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtinë. Datë: 8 dhjetor 2011 . Nr. ref.:AGJ 165/11. Paragrafët 64-67 dhe 68-75 (paragrafët 64-67 i takojnë seksionit "Pensionet për deputetë në vendet tjera", ku Gjykata jep një rezyme të legjislacionit të disa vendeve demokratike perëndimore për të parë se si ato e kanë të rregulluar çështjen e pensionit të deputetëve; në këtë kuptim, Gjykata ka gjetur se në disa vende ekziston një fond i veçantë për pensionet e deputetëve, në tjerat vende ky fond nuk ekziston por pensionet janë të përgjithshme, kurse në disa prej tyre bëhet kombinim i dy modeleve për të realizuar pensionin e deputetit; këta paragrafë pasohen nga paragrafët 68-75, të cilat i takojnë seksionit "Analizë e vendimeve të gjykatave të tjera kushtetuese" të Aktgjykimit, të cilat shtjellojnë praktikën kushtetuese lidhur me pensionet e deputetëve; në këtë vend, Gjykata ka analizuar vendimet e gjykatave kushtetuese të **Maqedonisë** dhe **Malit të Zi,** të cilat kishin shpallur si jokushtetuese ligjet për pensionet e deputetëve, të cilat kishin qenë të ngjashme me ligjin e Kosovës që Gjykata e shpalli si jokushtetues; këtu jepet edhe analiza e rastit të **Kroacisë**, kur **Kuvendi** kishte zvogëluar pensionet e deputetëve kroatë para se **Gjykata Kushtetuese** të merrte vendim për një gjë të tillë);
Rasti KO 29/11. Aktgjykim. Parashtruesit: Sabri Hamiti dhe deputetë të tjerë. Vlerësimi i kushtetutshmërisë të Vendimit te Kuvendit te Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit te Republikës se Kosovës, i datës 22 shkurt 2011. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë. Datë: 30 mars 2011. Nr. ref.: AGJ 107/11. Paragrafët: 72-74 (në këta paragrafë, Gjykata jep zgjidhjet dhe praktikat kushtetuese rreth zgjedhjes së shefit të shtetit në demokracitë parlamentare të **Evropës** ish-komuniste, me vështrim të veçantë në rastet e **Hungarisë** dhe **Shqipërisë**; fokusi në këto dy vende bëhet me qëllim që të tregohet se zgjidhjet dhe praktikat kushtetuese të tyre janë të njëjta me rastin e Kosovës, ku kërkohet zgjedhja nga kuvendi dhe me më shumë se dy kandidatë e në disa raunde votimi);
Rasti KO 45/12 dhe KO 46/12. Aktgjykim. Kërkesa e Liburn Aliut dhe 11 deputetëve të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe dhe të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtine. Datë: 25 qershor 2012. Nr.Ref.: AGJ 255/12. Paragrafët: 34, 69 (**Epperson kundër Arkansasit**, rast i vitit 1968 i gjykuar nga **Gjykata Supreme e SHBA**-ve, u përdor nga parashtruesit për të argumentuar se dy ligjet e Kosovës që përbënin objektin e kontrollit kushtetues ishin jokushtetuese; ky argument nuk u pranua nga Gjykata Kushtetuese sepse në rastin amerikan fjala ka qenë për një ligj të një shteti që synonte heqjen e teorisë së evolucionit në shkollë, duke përjashtuar teorinë biblike që bie ndesh me te; **Gjykata Kushtetuese** konstatoi se ky rast nuk argumenton asgjë për rastin konkret lidhur me dy ligjet si më sipër objekt kontrolli kushtetues. Ky rast, sipas saj, nuk përbënte një shembull për ta përjashtuar një proces të konsultimit me bashkësitë fetare në çështje të planifikimit në komunat kosovare kur kërkohet të ruhet trashëgimia kulturore; me këtë shihet qartë se bëhej fjalë për dy gjëra të ndryshme: në rastin amerikan fjala ka qenë për ruajtjen e parimit të laicitetit, të cilin synonte ta prish një ligj i një shteti amerikan duke ndaluar mësimin në shkolla të teorisë së evolucionit, kurse në rastin kosovar ligjet objekt kontrolli kushtetues kishin për qëllim të vetëm futjen e konsultimit me bashkësitë fetare për qëllim të ruajtjes së trashëgimisë kulturore e fetare të komuniteteve të Kosovës);
Rasti KO 57/12. Aktgjykim. Parashtrues: Kërkesa e Presidentes se Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së Saj, Atifete Jahjaga, me të cilën konteston votimin për miratimin e Ligjit nr. 04/1-084 "Për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë. Datë: 20 shtator 2012 . Nr. ref.: AGJ297/12. Paragrafët: 51-59 (në këtë rast Presidentja e Kosovës, znj. **Atifete Jahjaga** argumentonte se kishte pasur shkelje të nenit 80.4 i Kushtetutës, përkatësisht të drejtës së vetos së Presidentit të Kosovës nga neni 84.6 i Kushtetutës sepse nuk ishte marrë parasysh një amendament i propozuar nga ajo; pas shtjellimit komparativ të kushtetutave të **Bullgarisë, Francës, Greqisë, SHBA**-ve, **Portugalisë** dhe **Lituanisë**, në paragrafët si më sipër, në rend alfabetik, Gjykata Kushtetuese konstatoi se në **Kosovë** nuk ekziston e drejta e shefit të shtetit për të propozuar amendamente në ligjet e propozuara por vetëm e drejta e vetos, e cila mund të shfrytëzohet vetëm njëherë; nëse një herë shfrytëzohet kjo e drejtë, kurse Kuvendi i Kosovës me shumicën e votave të të gjithë deputetëve vendos për miratimin e ligjit të rikthyer nga Presidenti i Kosovës, atëherë ai ligj konsiderohet i shpallur);
Rasti K0 131/12 . Aktgjykim. Parashtrues: Dr. Shaip Muja dhe 11 deputete te Kuvendit të Republikës së Kosovës Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 18, 19,41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi, Nr. 04/L-125, te miratuar nga Kuvendi, më 13 dhjetor 2012. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë. Datë: 15 prill 2013. Nr. ref.: AGJ 404/13. Paragrafët: 91-97 (duke vendosur lidhur me të drejtën për punë dhe lirinë e ushtrimit të profesionit, Gjykata ka gjetur praktika të mira nëpër vendet e ndryshme, të cilat dëshmojnë se puna e dyfishtë e mjekëve specialistë nuk bie ndesh me normat kushtetuese dhe ligjore, përkatësisht se kufizimi i kësaj të drejte dhe lirie bie ndesh me normat kushtetuese dhe ligjore, si në aspektin komparativ ashtu dhe në kontekstin kosovar; praktikat e **Bosnje-Hercegovinës, Kroacisë** dhe të **Maqedonisë** kanë qenë fokus i krahasimit në këtë rast);
Rasti Ko. 95/13. Aktgjykim. Parashtrues: Visar Ymeri dhe 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit, Nr. 04/L-199, për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të Planit të zbatimit për këtë marrëveshje . **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë. Datë: 9 shtator 2013. Nr. ref.: AGJ 469/13. Paragrafët: 48-69 (këta paragrafë i takojnë seksionit "Analizë krahasimore" të Aktgjykimit, në të cilin Gjykata Kushtetuese ka dhënë krahasimin e dispozitave kushtetuese të vendeve që i takojnë sistemit të së **drejtës së përgjithshme, të Holandës** dhe të disa vendeve tjera Evropiane, për t'u ndalur në paraqitjen e zg-

të Venecias[87] dhe mekanizmit të tij të brendshëm, **Forumi i Venecias** (më shpesh përdoren si argument qëndrimet e këtij të fundit sepse reflekton përvojën nacionale të vendeve anëtare të Komisionit);[88] dhe, në fund, në grupin e tretë

jidhjeve dhe praktikës kushtetuese në **Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Maqedoni, Slloveni**; këtë e ka bërë Gjykata me qëllim të sqarimit dhe argumentimit të verdiktit të saj, që thotë se në **Kosovë** nuk ekziston e drejta e kontrollit kushtetues të marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare, as preventive e as represiv; praktika e disa vendeve lejon kontrollin preventiv të marrëveshjeve ndërkombëtare, në ndërkohë që në sistemin e të **drejtës së përgjithshme** ky nuk është fare rasti sepse nuk shtrohet çështja e ndonjë fuqie superiore të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në sistemin e brendshëm; në këto vende marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare nuk bëhen pjesë e rendit të brendshëm juridik por bëhet ligji me të cilin një marrëveshje përshkruhet në tërësi apo pjesërisht dhe merr formën e ligjit të brendshëm, ashtu që edhe ndryshimi i tyre bëhet sipas procedurës së ndryshimit të ligjeve të zakonshme sepse, në fakt, ato marrëveshje kanë formën e ligjit; rasti **Holandës** është një përjashtim, ku Gjykata ka treguar se në këtë vend marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare kanë epërsi ndaj kushtetutës së vendit);
Rasti KO 108/13. Aktgjykim. Parashtrues: Albulena Haxhiu dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit, Nr. 04/L-209, për Amnisti. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë. Datë: 9 shtator 2013 . Nr. ref.: AGJ 471/13. Paragrafët: 101-116 (në seksionin "Dispozitat kushtetuese dhe ligjore për amnistinë", Gjykata ka dhënë një pasqyrë të shkëlqyer të zgjidhjeve kushtetuese dhe përvojave në vendet e ndryshme në **Evropë, Afrikë** dhe **Amerikë Latine** lidhur me natyrën e amnistisë, llojin dhe modalitetet e rregullimit të saj kushtetues, duke konstatuar se në parim ajo ka të bëj me veprat penale politike dhe të lidhura për një konflikt të caktuar, se për miratimin e saj kërkohet baza kushtetuese dhe një shumicë e kualifikuar dhe se procesi i amnistisë duhet të jetë transparent që mos të vije deri te vet amnistia e kriminelëve dhe krimeve që janë ordinere dhe që nuk mund të jenë objekt i një amnistie; në këtë seksion poashtu jepen edhe përjashtimet nga kjo si më sipër, siç janë rastet e amnistive që kanë të bëjnë me krime ekonomike dhe kështu me radhë);
Rasti KO 103/ 14. Aktgjykim. Parashtrues: Presidentja e Republikës së Kosovës. Përkitazi me vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 84 (14) [Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverise] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë. Datë: 1 korrik 2014. Nr. ref.:AGJ671/14 . Paragrafët 31 – 38 (në seksionin "Analiza krahasimtare" të Aktgjykimit, ku hyjnë paragrafët 31-38, Gjykata ka dhënë zgjidhjet kushtetuese të vendeve të ndryshme që kanë të bëjnë me rolin dhe pozitën e shefit të shtetit gjatë procedurës së caktimit të mandatarit për themelimin e qeverisë; vendet zgjidhjet kushtetuese të të cilave janë krahasuar janë: **Shqipëria, Bullgaria, Kroacia, Gjermania, Greqia, Maqedonia, Portugalia** dhe **Sllovenia**; jo vetëm kaq: Gjykata ka dhënë edhe zgjidhjet dhe praktikën "kushtetuese" në Kosovë në kohën e **UNMI**K-ut, bazuar në **Kornizën Kushtetuese**; krejt kjo është bërë me qëllim të saktësimit se shefi i shtetit ka rol ceremonial në proces të caktimit të mandatarit të ri për kryetar qeverie dhe se fuqia e votës në zgjedhjet nacionale paraqet përcaktuesin kryesor me rastin e caktimit të mandatarit);
Rasti KO 119/14. Aktgjykim. Parashtrues: Xhavit Haliti dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit Nr. 05-V-001, të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 17 korrikut 2014. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtinë. Datë: 26 gusht 2014 Nr.ref.: AGJ700/14 . Paragrafët: 76-93 (në seksionin "Studimi krahasimtar, të cilit i përkasin këta paragrafë, jepet një pasqyrë e detajuar e zgjidhjeve kushtetuese dhe e rregulloreve të punës të parlamenteve nacionale lidhur me mënyrën e konstituimit të parlamentit pas përfundimi të zgjedhjeve nacionale; në veçanti fokusi përqendrohet në zgjidhjet kushtetuese e ligjore që kanë të bëjnë me mënyrën e formimit të organeve drejtuese të parlamenteve nacionale, të cilat duhet të reflektojnë një raport të caktuar të forcave politike të dal nga zgjedhjet e fundit nacionale; ndër vendet që janë trajtuar, bëjnë pjesë: **Shqipëria, Bullgaria, Kroacia, Gjermania, Greqia, Maqedonia, Portugalia** dhe **Sllovenia**).

87 Për rastet ku citohet **Komisioni i Venecias**, shih më shumë në vendimet si vijon:
Rasti KO 01/09. Aktgjykim . Parashtrues: Qemajl Kurtishi dhe Kuvendi Komunal i Prizrenit. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë. Datë: 18 mars 2010. Ref. Nr. AGJ 07/10, paragrafi 47 (ku Gjykata arsyeton të drejtën e komuniteteve të Kosovës për barazi të plotë në të gjitha sferat e jetës, duke u mbështetur në një raport të **Komisionit të Venecias**, **Raportin mbi të Drejtat e Joshtetasve dhe Pakicave**, miratuar në seancën plenare të Komisionit të mbajtur më 15-16 dhjetor 2006);
Rasti KO 73/16. Aktgjykim. Parashtrues: Avokati i Popullit. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Qarkores Administrative nr. 01/2016, të nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike të Republikës së Kosovës, me 21 janar 2016 . **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë. Datë: 8 dhjetor 2016 Nr. ref.: AGJ 1015/16. Paragrafët: 38, 81, 84-85 (në paragrafin 38, Gjykata flet për gjetjet relevante të **Komisionit të Venecias** që kanë të bëjnë me pavarësinë funksionale, organizative dhe financiare të institucioneve të pavarura, përfshirë gjykatat kushtetuese; në këtë paragraf theksi vihet në pavarësinë buxhetore të institucioneve të pavarura dhe të drejtën e tyre për të pasur buxhet të pavarur pa ndërhyrjen e organeve politike të pushtetit; këtë segment Gjykata e sforcon edhe më tej në paragrafin 81 ku flet për një vendim të **Gjykatës Kushtetuese të Bosnje-Hercegovinës**, me të cilin ligjvënësi i këtij vendi ishte detyruar për të siguruar pavarësinë e plotë buxhetore të **Gjykatës Kushtetuese të Bosnje-Hercegovinës**; në paragrafët 84-85, Gjykata ka cituar vendimet e gjykatave kushtetuese të **Shqipërisë** e **Lituanisë** respektivisht, në mbështetje të qëndrimit të njëjtë që këto gjykata kanë lidhur me pavarësinë dhe autonominë e tyre të tërësishme si parakusht për kryerjen e misionit të tyre kushtetues).

88 Jo rrallë, **Gjykata Kushtetuese** me rastin e vendosjes së rasteve të ndryshme kur nuk ka pasur praktikë gjyqësore të mjaftueshme ka kërkuar përgjigje dhe mendimin e gjykatave kushtetuese të vendeve anëtare të **Komisionit të Venecias**. Këtë e ka bërë duke iu drejtuar drejtpërdrejt mekanizmit të Komisionit, **Forumit të Venecias**. Nga vendimet e publikuara të Gjykatës shihet se ato përgjigje dhe mendime janë futur në punë në **ratio decidendi** të **Gjykatës Kushtetuese** me rastin e vendosjes lidhur me rastet konkrete. Shih për këtë rastet si vijon:
Rasti K0 142/16. Aktgjykim. Parashtrues: Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 10 dhe 40.1.5 të Shtojcës se Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë. Datë: 18 korrik 2017. Nr. ref.: AGJ 1107/17. Paragrafët: 40-47 (në këta paragrafë, të cilat i takojnë seksionit "Komentet kryesore të pranuara nga Forumi i Komisionit të Venecias", Gjykata flet për praktikat kushtetuese të vendeve të ndryshme të **Evropës** dhe botës, siç janë praktikat e gjykatave kushtetuese të **Bullgarisë, Kroacisë, Sllovakisë, Çekisë, Afrikës së Jugut** dhe **Sllovenisë**; nga përgjigjet e marra përmes **Forumit të Venecias**, bëhet e qartë se interesat e kreditoreve preken me procedurat e likuidimit dhe falimentimit; për këtë arsye, sipas **Forumit të**

të burimeve të së drejtës hyjnë praktika e **Gjykatës Evropiane të Drejtësisë** (GJED) dhe **Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë** (GJND).[89] Me përjashtime të vogla, në tri llojet e sipërcekura, çdoherë bëhet fjalë për vendimmarrje meritore, përkatësisht për aktgjykime të **Gjykatës Kushtetuese** në të cilat ekziston argumentimi duke u mbështetur në burime të huaja juridike.[90]

Venecias, interesat e kreditorëve mbrohen dhe realizohen në procedura gjyqësore);
Rasti K0 12/18. Aktgjykim. Parashtrues: Albulena Haxhiu dhe 30 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 04/20, te 20 dhjetorit 2017. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtinë. Datë: 11 qershor 2018 Nr. ref.: AGJ 1258/18. Paragrafët: 62-73 (duke folur për gjetjen e **Forumit të Venecias**, Gjykata tregon se në parim shtetet me ligje përkatëse dhe të veçanta rregullojnë pagat e zyrtarëve të tyre në nivel qendror dhe lokal, të gjyqtarëve, prokurorëve dhe kategorive tjera të zyrtarëve shtetëror; si dëshmi për këtë, Forumi ka theksuar përvojat shtetërore, të paraqitura përmes gjykatave kushtetuese të vendeve evropiane si vijon: **Austrisë, *Çekisë, Maqedonisë, Bosnje-Hercegovinës, Kroacisë, Sllovenisë; Gjermanisë, Sllovakisë, Letonisë, Suedisë*** *dhe* ***Moldavisë****; sa i përket juridiksionit në këtë rast,* ***Forumi i Venecias*** *ka theksuar se në të shumtën e rasteve normat e përgjithshme, që kanë formën e rregulloreve të qeverisë i nënshtrohen kontrollit kushtetues, siç i nënshtrohet edhe aktet tjera juridike të ekzekutivit pa marrë parasysh emërtimin dhe statusin e tyre formal).*

89 Lidhur me praktikat e **GJED** dhe **e GJND**-së, ashtu siç janë cituar nga Gjykata Kushtetuese, shih më shumë në vijim:
Rasti KO 13/15, paragrafi 58 (ku Gjykata Kushtetuese ka cituar një vendim të **GJED** për të mbështetur argumentin e për mosfutjen e kuotave të detyrueshme gjinore për postet ministrore në nivel nacional; thelbi i kërkesës në këtë rast ka qenë që përmes amendamentit kushtetues, të propozuar nga një grup i grave deputete të **Kuvendit të Kosovës**, të futej në kushtetutë dispozita për kuotat e detyrueshme gjinore në nivel të ekzekutivit nacional; lidhur me këtë Gjykata tha se një rregullim kushtetues i kuotës gjinore për pozicionet ministrore dhe zëvendësministrore mundet, në praktikë, të shndërrohet në një zëvendësim formal të një personi të gjinisë së njëjtë që mund t'i zvogëlojë të drejtat e njerëzve të tjerë, qoftë deputetë ose persona të kualifikuar, për t'u bërë pjesë e ekzekutivit nacional);
Rasti KI 25 /10. Aktgjykim. Parashtrues: Agjencia Kosovare e Privatizimit. Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit te Dhomës se Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-09-089, të 4 shkurtit 2010. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë. Datë: 31 mars 2011. Nr. ref.: AGJ 109/11 . Paragrafi 54 (ku Gjykata i referohet mendimit këshillëdhënës të **GJND**-së për Kosovën të datës 22 korrik 2010, në mbështetje të arsyetimit të saj se të gjithë gjyqtarët ndërkombëtarë në Kosovë, të cilët në kohën e marrjes së vendimit ishin pjesë e **Misionit EULEX**, kanë pasur detyrim për të vënë në jetë Kushtetutën e vitit 2008 dhe ligjet e Kosovës; ky detyrim kushtetues, sipas Gjykatës përfshinte edhe gjyqtarët e **Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës**, e cila në atë kohë refuzonte të zbatonte infrastrukturën kushtetuese dhe ligjore të Kosovës, duke argumentuar se mandatet e tyre i lejonte të qëndrojnë mbi atë infrastrukturë).

90 Për rastin e aktvendimeve, si vendime jomeritore, të cilat përmbajnë referenca në të drejtën e huaj, Cf. më shumë në:
Rasti KO 126/16. Aktvendim. Gjykata referuese: Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtinë. Datë: 30 maj 2017. Nr. ref.:RK 1086/17. Paragrafët: 46-48, 65-66 (në tre paragrafët e parë, Gjykata ka definuar konceptin e kontrollit incidental nga aspekti krahasimor duke dhënë elementet e tij përbërëse; nga analiza krahasimtare e Gjykatës del se gjykatat e rregullta të shumicës së shteteve evropiane janë të autorizuara të parashtrojnë kërkesë në gjykata kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitave specifike ligjore (në disa vende edhe të akteve të tjera), të cilat duhet të zbatohen drejtpërdrejt në një rast gjyqësor konkret; një autorizim i tillë ekziston në **Shqipëri, në Armeni, në Belgjikë**, në **Bosnjë dhe Hercegovinë**, në **Kroaci**, në **Republikën Çeke**, në **Hungari**, në **Itali,** në **Maqedoni**, në **Rumani**, në **Sllloveni,** në **Spanjë**, në **Turqi;** në disa shtete, si: në **Bullgari**, në **Greqi** dhe në **Letoni,** vetëm gjykatat më të larta janë të autorizuara për inicimin e kontrollit incidental në gjykatat kushtetuese; në fund, në paragrafët 65-66, Gjykata ka dhënë praktikën e **Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë** dhe të **Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë** në mbështetje të argumentit të vet lidhur me lidhjen e drejtpërdrejtë që duhet të ekzistoj në mes të rastit dhe normës së kontestuar që duhet të zbatohet në zgjidhjen e tij);
Rasti KO 79/18. Aktvendim. Parashtrues: Presidenti i Republikës së Kosovës. Kërkesë për interpretim të nenit 139, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtinë. Datë: 3 dhjetor 2018. Nr. ref.: RK 1294/18. Paragrafët: 39-41 & 76 (në këta paragrafë Gjykata Kushtetuese i ka dhënë pyetjet që vetë ia ka parashtruar **Forumit të Venecias së bashku me përgjigjet që ka marrë nga i njëjti; nga përgjigjet del se në vendet evropiane nuk ekziston një përkufizim kushtetues i grupeve parlamentare; nga përgjigjet e Forumit po ashtu del se komisionet qendrore zgjedhore janë komisione të p**ërhershme dhe profesionale që përbëhen nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme, atyre qeveritare dhe të gjyqësorit; ato janë të përbëra nga anëtarë që propozohen qoftë drejtpërsëdrejti nga partitë politike, apo nga grupet parlamentare të përfaqësuara në parlamentet nacionale; në paragrafin 76, Gjykata ka dhënë zgjidhjen ligjore të **Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Gjermanisë** të vitit 1951, që dikur lejonte dhënien e mendimeve këshillëdhënëse nga ana e kësaj gjykate; më vonë, në vitin 1956, me ligj, kjo kompetencë e **Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë** u suprimua; duke u bazuar në këtë zgjidhje ligjore gjermane, **Gjykata Kushtetuese e Kosovës** në mënyrë të gabuar krahason rastin e mendimeve këshillëdhënëse që janë dhënë në të kaluarën sipas kërkesave të shefit të shtetit dhe të ekzekutivit kosovar; Gjykata me të drejtë konstaton se kjo praktikë ka qenë e gabuar nisur nga fakti se vërtetë këto organe nuk mund të paraqiten si palë në procedurë jashtë standardeve të nenit 113 të Kushtetutës, si dhe atyre rasteve që janë të përcaktuara me një ligj të veçantë; një rast i tillë, ta zëmë, akoma ekziston në favor të ekzekutivit kosovar në nenin 64.3 ["Shkarkimi"] të **Ligjit Nr. 03/L-04 për Vetëqeverisjen Lokale**, të 20 shkurtit 2008, ku parashikohet mundësia e shkarkimit të kryetarit të komunës, shkarkim që merr fuqi të plotë vetëm pas konfirmimit të tij nga **Gjykata Kushtetuese**; këtë e kemi sqaruar në kapitullin kap. 11.3.10 të këtij libri, kur kemi folur për juridiksionin shtesë të caktuar me ligj të **Gjykatës Kushtetuese**, si dhe në **Komentarin e Kushtetutës së Kosovës** të vitit 2013, të zënë në gojë më herët; praktika e **Gjykatës Kushtetuese të Kosovës,** thënë shkurt, është krijuar përmes praktikës, jo bazuar në norma ligjore si në rastin e **Gjykatës**

Para se të kalojmë në diskutimin lidhur me aspektet krahasimore të nivelit **horizontal** dhe **vertikal** të **stare decisis** në sistemin tonë kushtetues, duhet t'i themi dy fjalë lidhur me dallimet në mes të **Kosovës** dhe vendeve të tjera që po ashtu janë të hapura ndaj ndikimit të burimeve të huaja të së drejtës kushtetuese. Në këtë kuptim, në krahasim me vendet tjera, në **Kosovë** ekzistojnë disa dallime që janë shumë specifike. Të tilla çfarë ekzistojnë në Kosovë gjenden shumë rrallë gjetiu nëpër botë: zakonisht si shembull përmendet rasti i **Bosnje-Hercegovinës**. Dallimet specifike si më sipër në kontekstin kosovar ekzistojnë në dy aspekte. I pari ka të bëjë me dokumentet dhe instrumentet juridike regjionale dhe ndërkombëtare, të cilat, sipas fuqisë së nenit 22 të Kushtetutës, janë përbërës të normës kushtetuese: të gjitha autoritete publike dhe individët e kanë detyrim kushtetues për ta zbatuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në tërë territorin e Kosovës. I dyti i referohet marrëveshjeve dhe traktateve ndërkombëtare të ratifikuara nga ana e Kosovës, të cilat kanë fuqi më të lartë se çdo ligj apo normë tjetër përveç normës kushtetuese: i vetmi përjashtim nga kjo rregull kushtetuese gjendet në dispozitën e nenit 33.1 të Kushtetutës, e cila ka të bëj me normat **jus cogens** të së drejtës penale ndërkombëtare.

Në përgjithësi, në vendet ku ka një traditë të gjatë të zbatimit të doktrinës **stare decisis,** e njëjta operon si në rrafshin **horizontal** ashtu dhe në atë **vertikal.**[91] Në rrafshin e parë, kjo doktrinë imponon detyrimin për respektim nga ana e gjykatave përkatëse të vendimeve të tyre të mëparshme, përkatësisht detyrimin për trajtim të vendimeve vetanake nga e kaluara si pikë referimi të detyrueshëm kushtetues dhe ligjor me rastin e zgjidhjes apo vendosjes së situatave dhe rasteve aktuale të ngjashme apo identike. Rrafshi i dytë i operimit të doktrinës **stare decisis** nënkupton respektimin dhe vënien në jetë të vendimeve të gjykatave më të larta. Caqet e këtyre efekteve dallojnë në dy sistemet e së drejtës: në **sistemin civil** të së drejtës, këto efekte kanë të bëjnë, në parim, me vendimin gjyqësor, jo me mendimet mospajtuese dhe konkurruese. Kjo është kështu për shkak se në këtë sistem, mendimet mospajtuese dhe konkurruese nuk janë pjesë e vendimeve gjyqësore: vendimi gjyqësor është unik dhe nuk mund të ketë si shtojcë mendimet mospajtuese apo konkurrente të pakicës.[92] Kjo nuk është kështu në sistemin e të **drejtës së përgjithshme**, në të cilin sistem mendimet mospajtuese dhe konkurruese lejohen dhe janë pjesë e vendimit gjyqësor. Në gjyqësinë kushtetues, përfshirë **Kosovën**, ky dallim është prishur ashtu që sot ka një **hibridizim** sepse mendimet mospajtuese dhe konkurruese publikohen së bashku me vendimin e shumicës ani se nuk janë pjesë përbërëse e vendimit kryesor mbi meritat e rastit.

Në vijim, si më sipër, efekti vertikal i vendimeve meritore të gjykatave kushtetuese të proveniencës **kelseniane/evropiane**, sikundër do të argumentohet në vijim, sigurohet **per constitutionem**: kushtetutat nacionale garantojnë efektin **stare decisis** të vendimeve të gjykatave kushtetuese. Me këtë efekt përfshihen të gjitha çështjet kushtetuese të përfshira me vendimin meritor, të cilat kanë qenë objekt i gjykimit dhe vendosjes përfundimtare. Si i tillë, **stare decisis** në këto vende shtrihet ndaj të gjitha subjekteve të së drejtës që gjenden në pozitë për të vënë në jetë përmbajtjen e vendimit. Një sanksionim si ky kushtetues i caqeve të veprimit të **stare decisis** paraqitet edhe në **Kosovë**: Kushtetuta në mënyrë shprehimore thotë se vendimet e **Gjykatës Kushtetuese** "[…] janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës".[93]

Kushtetuese të Gjermanisë; me këtë arsyetim, si dhe me arsyetimet e dhëna nga **Forumi i Venecias**, të cilat i ka marrë si bazë në arsyetimin e vet, **Gjykata Kushtetuese e Kosovës** ka argumentuar për themeltësisë së kërkesës dhe në nivel të dhënies së vendimit meritor, në ndërkohë që vendimi i saj ka natyrë të vendimit jomeritor; jo vetëm kaq: Gjykata ka konstatuar në parag. 81, në mënyrë krejt të gabuar, se çështja e emërimit të anëtarëve të **KQZ** përbën një çështje ligjore sepse rregullohet me nenin 61 para. 3 (a) të **Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës,** *të datës 15 qershor 2008***;** ky konstatim është jologjik fund e krye për shkak se pikërisht në paragrafin 10 të nenit 113 të Kushtetutës përcaktohet se juridiksioni shtesë mund të rregullohet me ligj, diçka që ligjvënësi kosovar e ka bërë me dispozitën e sipërcekur të nenit 61 para. 3 (a) të **Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.**

91 Joseph J. Arvay, Q.C., Sheila M. Tucker and Alison M. Latimer, "Stare Decisis and Constitutional Supremacy: Will Our Charter Past Become an Obstacle to Our Charter Future?". *The Supreme Court Law Review: Osgoode's Annual Constitutional Cases Conference* Vol. 58. (2012). fq. 61-85, në fq. 64-75.

92 Fon & Francesco Parisi, "Judicial precedents in civil law systems: A dynamic analysis", fq. 525.

93 Neni 116 ["Efekti Juridik i Vendimeve"] i Kushtetutës.

Ky kuptim i **stare decisis**, i normuar me norma kushtetuese, e bën Kosovën të jetë pjesë e **sistemit hibrid**. Kjo sepse statusi kushtetues i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në nivel **vertikal** konsiston në gëzimin nga ana e tyre të një epërsie absolute kundrejt vendimeve të gjyqësorit të rregullt dhe vendimeve të autoriteteve të tjera publike në vend. Të gjithë autoritetet gjyqësore në Kosovës, si dhe të gjithë subjektet e drejtës, me rastin e vendosjes janë të detyruar që të shërbehen me atë **ratio decidendi** që gjendet brenda vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, pa asnjë mundësi kualifikimi apo riinterpretimi. Ky kuptim i **stare decisis** është më i ngushtë se **efekti juridik** i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese: në rastin e dytë, fjala është për efektin që kanë vendimet e Gjykatës ndaj të gjithëve, përfshirë individët. Këtu flitet për respektim të vendimeve, pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për përdorimin e **radio decidenti** të tyre në një rast konkret. Thënë fare thjeshtë, në rastin e **efektit juridik** të vendimeve fjala është për respektimin e tyre si vendime të autoriteteve publike, ani se individët, gjyqësori apo autoritetet tjera publike mund të mos kenë fare nevojë të thirrën në **radio decidendi** të tyre për nevoja praktike.

Gjykata Kushtetuese ka vënë në jetë dyja këto rrafshe të doktrinës **stare decisis**. Laikët që janë mësuar me ndarjen e sistemeve juridike në **sistemin civil** dhe në sistemin e të **drejtës së përgjithshme**, me siguri se do të nguten për të konstatuar se **Kosova** bën pjesë në grupin e parë dhe, për pasojë, nuk mund të bëhet fjalë për vënien në jetë të doktrinës **stare decisis** as në rrafshin **horizontal** e as në rrafshin **vertikal.**

Nga shtjellimet e mëhershme u pa se kjo, megjithatë, nuk është kështu: në Kosovë bëhet fjalë më shumë se për vënien në jetë të doktrinës **stare decisis**. Sikundër u tha, **Gjykata Kushtetuese** në vendimmarrjen e saj nuk ndjek vetëm **stare decisis** të **GJEDNJ**, i cili çon domosdo në të **drejtën e huaj** dhe në praktikat tjera jashtë atyre që tradicionalisht shërbejnë si bazë e vendimmarrjes së saj. Përjashtim bëjnë vetëm citimet e autorëve vendorë dhe të huaj nga bota akademike. Këtë e konstatuam më sipër. Nga burimet tjera, krahas të **drejtës së butë**, **Gjykata Kushtetuese** ndjek me zell të madh praktikën e gjykatave të huaja kushtetuese dhe organeve të tjera publike, si dhe zgjidhjet relevante kushtetuese e ligjore të shteteve dhe entiteteve të ndryshme. Të shohim si duken këto praktika që ndiqen nga **Gjykatës Kushtetuese**.

Nuk ekziston një vendim i **Gjykatës Kushtetuese** në lëmin e lirive dhe të drejtave të njeriut që mos të ketë të cituar së paku një vendim të **GJEDNJ**, duke e marrë si bazë për arsyetimin e verdiktit të vet. Kjo, sikundër u tha, ka qenë praktikë sistematike e **Gjykatës Kushtetuese** që nga dita e parë e themelimit, e bazuar në një detyrim të qartë kushtetues nga neni 53 i Kushtetutës.[94] Këtu bëhet fjalë për **stare decisis** që bazohet në **metodën e case-law**, përkatësisht në metodën e analizimit dhe vënies në jetë të precedentit me origjinë nga **Gjykata e Strasburgut**. Kjo nënkupton se **Gjykata Kushtetuese**

[94] Vënia në jetë e lirive dhe të drejtave njerëzore, të garantuara me kushtetutë, përbën arsyen themelore për krijimin e **stare decisis** edhe në një vend tjetër. E kemi fjalën për **Gjermaninë**. Kjo praktikë, e nisur që në vitet '50 të shekullit XX me rastin e njohur si rasti ***Lüth***, ka bërë që në **Gjermani** të instalohet një **sistem hibrid** i drejtësisë ku interpretimi i unifikuar i ligjit në përputhje me liritë dhe të drejtat e njeriut. Ky interpretim i unifikuar i ligjit arrihet përmes komentarëve të ligjeve kryesore sistemime, duke pasur parasysh germën dhe fryn e lirive dhe të drejtave të garantuare kushtetuese. Cf. Frank Emmert, "Stare Decisis: A Universally Misunderstood Idea", fq. 224-225.
Kjo qasje nuk paraqitet ndryshe në **Kosovë:** përmes detyrimit kushtetues nga neni 53 i Kushtetutës për të zbatuar standardet e **GJEDNJ** në lëmin e lirive dhe të drejtave të njeriut ka pasur për pasojë që në komentarët e ligjeve sistemike kosovare të fillojë praktika e interpretimit uniform të tyre. Kjo ka prodhuar edhe një pasojë tjetër - zbatimin e ligjeve sistemike në mënyrë të njëjtë në tërë territorin e **Kosovës**. Një gjë e tillë nënkupton se, ndër ne, **sistemi hibrid** kushtëzohet në rend të parë nga detyrimi kushtetues për të zbatuar standardet e **GJEDNJ** në lëmin e lirive dhe të drejtave të njeriut. Në rastin gjerman, kjo pasojë është prodhuar përmes praktikës gjyqësore në rastin e sipërcekur ***Lüth***, ku zbatimi i drejtpërdrejtë i dispozitave kushtetuese mbi liritë dhe të drejtat e njeriut ka ndikuar në ndërtimin e praktikës së **stare decisis** ku mbizotëron jurisprudenca e **Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë** kundrejt çdo interpretimi tjetër të dhënë nga gjyqësori i rregullt. Ky standard sot ekziston në të gjitha vendet evropiane dhe më gjerë ku ekziston një gjykatë e ndarë kushtetuese, apo një gjykatë tjetër të barasvlefshme me te që ushtron juridiksion e kontrollit kushtetues në mënyrë të ndarë nga gjyqësori i rregullt. Kjo është kështu vetëm për ato vende që nuk i takojnë sistemit të së **drejtës së përgjithshme**, ku vlen e drejta e precedenteve apo **stare decisis**. Thënë ndryshe, ekzistimi i gjykatave të ndara kushtetuese apo i gjykatave tjera të barasvlefshme me to që ushtrojnë kontrollin e kushtetutshmërisë sipas juridiksionit të përcaktuar në mënyrë të qartë me kushtetutë ka bërë që **stare decisis** apo e drejta e precedenteve të fitojë një status, pozitë dhe hapësirë kushtetuese edhe në sistemin e të drejtës civile.

në tërësi miraton dhe pranon narrativin ashtu siç është parë, vendosur dhe interpretuar në **GJEDNJ**, narrativ që përbëhet nga dy pjesë: pjesa që flet për mënyrën e krijimit të rastit në nivel nacional, kurse pjesa e dytë ka flet për bazën juridike që është zbatuar në vendin e origjinës së lindjes së rastit konkret.

Krahas këtij lloji të **stare decisis** ekziston edhe një tjetër lloj i precedentit. Ai bazohet në metodën tekstuale, përkatësisht në metodën e pranimit (miratimit) tekstual të tekstit të arsyetimit të dhënë në një vendim dhe atë jashtë kontekstit vendor. Këtu bëhet fjalë për pranim tekstual, **ad literam**, të përvojës së huaj që ka të bëj me interpretimin e normave kushtetuese. Në literaturë kjo quhet **metoda e tekstualizimit të precedentit** dhe gjen zbatim në rastet që nuk kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat e njeriut. Si e tillë, kjo metodë hyn në punë në ve**ç**anti në sferën e kontrollit të kushtetutshmërisë së normave juridike.[95]

Ajo që është e detyrueshme si precedent në rastin e metodës së parë konsiston në pranimin si parametër për vendosje të një situate reale faktike nga e kaluara, përkatësisht në miratimin e historisë së procesit të formimit (lindjes) të rastit në nivel nacional dhe të vetë mënyrës se si është interpretuar (zgjidhur) situata faktike nga **Gjykata e Starsburgut.** Në rastin e metodës së dytë, ndërkaq, si detyrim me natyrë precedenti paraqitet vetëm teksti i prodhuar jashtë vendit (teksti i huaj nacional), i marrë si i shkëputur nga çdo ngjarje reale faktike. Në rastin e metodës së fundit, pranimi (miratimi) si parametër për vendosje i tekstit të huaj nga gjykata nacionale, pa marrë parasysh gjendjen reale faktike të lindjes së rastit, shoqërohet me një analizë të caktuar të tij me qëllim të përshtatjes rrethanave të rastit konkret nacional që pret zgjidhje. Këtu teksti i analizuar shërben në të njëjtën kohë si bazë e juridiko-kushtetuese e vendimmarrjes. Arsyetimi i vendimmarrjes gjyqësore në rastin e parë është i lidhur për analizën e gjendjes reale jetësore, kurse në të dytin ndiqet logjika e arsyetimeve që një ligjvënës i huaj e jep me rastin e draftimit të ligjeve.[96]

Dy këto metoda kanë qenë dhe janë prezente në praktikën e **Gjykatës Kushtetuese.** Vlen të theksohet se metoda e parë në **Kosovë** më shumë ka të bëjë dhe gjen vend tek gjykimet në lëmin e lirive dhe të drejtave të njeriut, përkatësisht me rastet e gjykimeve nga neni 113.7 i Kushtetutës, kurse metoda e dytë ka të bëjë kryesisht me kontrollin abstrakt të normës juridike si dhe me **ç**do kontroll tjetër të kushtetutshmërisë ku **Gjykata Kushtetuese** ka juridiksion origjinal, siç janë, ta zëmë, rastet e konfliktit për kompetencë,[97] kontrolli kushtetues i referendumit,[98] kontrolli kushtetues i shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme,[99] kontrolli kushtetues i zgjedhjeve parlamentare,[100] procedurat rreth **impeachment**-it të **Presidentit të Republikës**[101] etj.

13.3.1. Caqet e *stare decisis* në procedurën e caktimit të masave të përkohshme

Në lëmin e vënies së masave të përkohshme, **stare decisis** ka një veprim thuajse inekzistent, si në planin **horizontal** ashtu dhe në atë **vertikal**.

Sa i përket operimit horizontal të masave të përkohshme, **stare decisis** nuk ka asnjë kuptim sepse në rast të vënies së tyre në jetë, atëherë vjen në shprehje efekti i përgjithshëm i vendimeve të **Gjykatës Kushtetuese** në kuptim të nenit 116.1 të Kushtetutës ["Efekti Juridik i Vendimeve"] . Kjo dispozitë përcakton se "[...] Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës".

Në kuptim të operimit vertikal të **stare decisis**, ndërkaq, gjendja është e njëjtë: si me çdo vendim tjetër

---

95 *Jan Komárek*, "Reasoning with Previous Decisions: Beyond the Doctrine of Precedent", në fq. 151-156.

96 Ibid. fq. 157-158

97 Neni 113.3 (1) ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] i Kushtetutës.

98 Neni 113.3 (2) ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] i Kushtetutës.

99 Neni 113.3 (3) ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] i Kushtetutës.

100 Neni 113.3 (5) ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] i Kushtetutës.

101 Neni 113. 6 ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] i Kushtetutës.

të mëparshëm të **Gjykatës Kushtetuese,** çdoherë dhe në çdo kohë Gjykata mund të ndryshojë **stare decisis**-in e vet nëse plotësohen dy kushte:

- e para, nëse bëhet fjalë për vendime meritore; dhe,
- e dyta, nëse vendimi me të cilin ndryshohet precedenti arsyetohet mirë dhe gjerësisht për të evituar çdo mundësi për akuza për arbitraritet.

Kjo nënkupton se si **stare decsis** në kuptimin të operimit vertikal vlejnë vetëm ato vendime që janë në fuqi ditën e vendosjes së rastit të ri, jo ato që janë shfuqizuar nga Gjykata. Në rastin e operimit vertikal, ndërkaq, nuk shtrohet çështja fare sepse me ndryshimin e precedentit të mëparshëm nuk ndryshon detyrimi për zbatim i tij nëse ai veç ka prodhuar efektin e vet në ndërkohë.

Të shohim pak më shumë si duket fizionomia e efekteve të përgjithshme të vendimeve të **Gjykatës Kushtetuese**, për aq sa ato kanë të bëjnë me **stare decisis** dhe operimin e tyre horizontal.

Në kuptim të dispozitës së nenit 116.1 të Kushtetutës, vendimi i **Gjykatës Kushtetuese** me të cilin vihet masa e përkohshme ka efekt të përgjithshëm juridik: çdo gjykatë, organ publik apo individ duhet të zbatojnë vendimin nëse ai iu adresohet atyre me dispozitivin e tij. Kjo nënkupton se, në të njëjtën kohë, vendimi për vënien e masës së përkohshme nuk ka pse të prodhojë efekte juridike për asnjërin prej subjekteve nga neni 116.1 i Kushtetutës (gjykatat, personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës) nëse ai vendim nuk iu adresohet atyre (nuk ka të bëjë me ta).

Në kuadër të kërkesave që përmban një vendim për vënien e masës së përkohshme mund të jenë kërkesa për pezullim të ekzekutimit të një ligji, të një vendimi gjyqësor, të ndonjë veprimi tjetër të organit përkatës publik kosovar etj. Emërues i përbashkët i tyre është urdhri drejtuar autoriteteve publike për pezullimin apo ndalimin e një veprimi të caktuar. Thënë me fjalë tjera, kur **Gjykata Kushtetuese** miraton kërkesën për vënien e masës së përkohshme, atëherë vjen deri te pezullimi apo ndalimi për një periudhë të caktuar me vendim i ndërmarrjes nga ana e autoritetit përkatës publik të një veprimi të caktuar.[102] Një gjë e tillë përbën esencën e **efektit të përgjithshëm** të vendimeve të Gjykatës, i cili dallon nga **stare decisis**: në rastin e parë, me rastin e vënies në jetë të vendimit për vënien e masës së përkohshme gjykatat, organet apo individët nuk përdorin **ratio decidendi** që ka përdorur **Gjykata Kushtetuese** përgjatë arsyetimit të vendimit të vet. Kjo, në fakt, as nuk ka nevojë fare të ndodhë sepse vënia e masës së përkohshme nuk i referohet një gjendjeje përfundimtare, por një situate të përkohshme e cila adresohet me qëllim që e njëjta mos të prodhojë pasoja të caktuara të cilave Kushtetuta, ligji dhe rregullat e brendshme të Gjykatës u njohin (atribuojnë) cilësi të caktuara.[103] Se kjo është kështu shihet qartë edhe nga fakti se **efekti i përgjithshëm** vlen edhe atëherë kur procedura pezullohet **per constitutionem** me vetë aktin e paraqitjes së kërkesës në Gjykatë në bazë të nenit 113.3 (4) ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] të Kushtetutës. Në një rast të tillë, akti i njoftimit të palës apo palëve kundërshtare dhe aktorëve tjerë të interesuar paraqet pengesë për zhvillim të procedurave dhe ka efektin e masës së përkohshme, ani se nuk ka vendim formal për një gjë të tillë.[104] Kjo është pasojë e konceptit mbi **efektin e përgjithshëm** të veprimeve të Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenin 116.1 të Kushtetutës. Në këto raste, adresanti apo subjekti të cilit i drejtohet pjesa operative e vendimit që duhet të zbatohet, përdor arsyet për vënien e masës së përkohshme, ashtu siç janë dhënë nga **Gjykata Kushtetuese**, si bazë për t'i dhënë efekt konkret zbatimit të vendimit për

---

[102] Nuk ekziston një afat se deri kur duhet të zgjasin masat e përkohshme të mbrojtjes. Kjo çështje ngelet në diskrecion të Gjykatës Kushtetuese, e cila duhet të vlerësoj kohëzgjatjen e masave të përkohshme për secilit rast veç e veç. Kjo mund të konkludohet nga dispozitat e nenit 27.2 ["Masat e përkohshme"] të Ligjit nr. 03/L-121 dhe dispozitat e rregullit 27 (6) të Rregullave të Procedurës (**RP**). Të parat dispozita përcaktojnë se masat duhet të jenë të arsyeshme dhe proporcionale, kurse të dytat e qartësojnë faktin se vendimi për masat e përkohshme nuk mund të merret pa u ditur saktë data e skadimit të tyre.

[103] Pieter van Dijk, Fried van Hoof, Arjen Van Rijn, Leo Zëaak (eds.)., *Theory and Practice of the European Convention on Human Rights: Fourth Edition. Fourth Edition* (Intersentia: Antwerpen and Oxford, 2006) fq. 113.

[104] Neni 36 ["Efekti Suspensiv"] i **Ligjit nr. 03/L-121**:
"Ngritja e kërkesës sipas nenit 113, paragrafi 3, pika 4 të Kushtetutës ka efekt pezullues. Kuvendi i Republikës se Kosovës vepron në bazë të ndryshimit te kontestuar vetëm pasi është marrë vendimi i Gjykatës Kushtetuese".

vënien e masës së përkohshme. Përdorimi i arsyeve të Gjykatës Kushtetuese nga ana e adresantit apo subjektit vendimzbatues nuk përbën një stare decisis, por zbatim të vendimit **ad literam**, ashtu siç është miratuar nga Gjykata.

Në jurisprudencën e **GJEDNJ** dy kushte janë që duhet të plotësohen për vënien e masave të përkohshme ndaj një shteti: e para, faktet duhet të flasin **prima facie** për cenim të dispozitave të **KEDNJ**; dhe, e dyta, dështimi (ometimi) për vënien e masave të përkohshme të mbrojtjes duhet të rezultojë apo paraqes kërcënim për shkaktimin e dëmit të paripareshëm ndaj interesave të caktuara vitale të palëve ose vetë procesit të shqyrtimit të rastit. E drejta kosovare definon, përmes një formulimi të ndryshëm, por me efekt shumë të ngjashëm, cilësitë potenciale të pasojave të dëmshme që vendimi për vënien e masës së përkohshme të mbrojtjes synon t'i parandaloj nga ndodhja. E kemi fjalën këtu për Kushtetutën, **Ligjin nr. 03/L-121** dhe **RP**, dispozitat e të cilave trajtohen në vijim.

Dispozita e nenit 116.2 të Kushtetutës e cilëson si "dëme të pariparueshme" ekskluzivisht pasojën e dëmshme që Gjykata Kushtetuese nuk e lejon të ndodhë përmes vënies së masës së përkohshme.[105] Ky cilësim nuk është i njëjtë me atë që e gjejmë në **Ligjin nr. 03/L-121**, i cili zgjeron pasojat që mund të ndodhin në rast të mosvënies së masës së përkohshme nga ana e Gjykatës. Një orientim i tillë gjendet i formuluar në mënyrë shprehimore në dispozitën e nenit 27.1 ["Masat e përkohshme"] të **Ligjit nr. 03/L-121**, ku thuhet si vijon:

"[…] 1. Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa te përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik".[106]

Sikundër shihet, as Kushtetuta e as **Ligji nr. 03/L-121** nuk definojnë se çka nënkuptohet me rrezik apo dëm të pariparueshëm dhe me cenim (dëmtim) të interesit publik. Dispozitat e sipërcekura vetëm japin cilësitë që duhet të posedojë një pasojë e dëmshme apo një dëm i pariparueshëm. Për më tepër, kur bëhet fjalë për interesin publik, as cilësitë themelore të tij nuk jepen nga kushtetutëbërësi dhe ligjvënësi kosovar. Këtë nuk e bëjnë as dispozitat e **RP**, të cilat rregullojnë në mënyrë të detajuar procedurën dhe kushtet për caktimin e masave të përkohshme.[107] Duke ndjekur një procedurë të përcaktuar qartë në dispozitat e rregullave 56 & 57 të **RP**, Gjykata me rastin e vënies së masave të përkohshme duhet të konstatojë plotësimin në mënyrë kumulative të tri kushteve:

- e para, që pala e cila kërkon masën e përkohshme të ketë dëshmuar për meritat *prima facie* të kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, të ketë dëshmuar pranueshmërinë **prima facie** të kërkesës;
- e dyta, që pala e kërkon masë të përkohshme të ketë dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme; dhe
- e treta, që masa e përkohshme të jetë me interes publik.

Në asnjë dispozitë kushtetuese, ligjore apo në rregullativën e brendshme procedurale, megjithatë, nuk definohet koncepti i dëmit, përkatësisht i rrezikut nga shkaktimi i dëmit.[108] Një gjë e tillë duhet të bëhet vetë nga **Gjykata Kushtetuese** gjatë procesit të konstatimit nëse janë plotësuar tri kushtet si më sipër për vënien e masave të përkohshme. Vlerësimi bazohet në të drejtën materiale, vendore dhe krahasuese,

---

[105] Neni 116.2 ["Efekti Juridike i Vendimeve"] i Kushtetutës: "[...] Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktojë dëme të pariparueshme".

[106] Ky nen, në paragrafin e dytë e jep edhe një cilësi tjetër të vendimit për vënien e masës së përkohshme: ajo cilësi ka të bëjë me kohëzgjatjen e saj, e cila duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale. Me fjalë tjera, masa e përkohshme nuk guxon të jetë e pakufi, por saktësisht duhet të ketë një datë kur përfundon efekti i saj i përgjithshëm.

[107] Rregullat 56 & 57 ["V. Masat e Përkohshme"] të **RP**.

[108] Rregulli 57. 4 ["Vendimi për masë të përkohshme"] i **RP.**

si dhe në standardet e vëna nga **Gjykata e Strasburgut**, për aq sa vënia e masave afekton (prekë) në mënyrë përfundimtare dhe pakthyeshëm mbrojtjen dhe realizimin efektiv të lirive dhe të drejtave të garantuara kushtetuese. Në rastet kur ky nuk është rasti, pra kur vendimi për caktimin e masës së përkohshme nuk afekton pakthyeshëm liritë dhe të drejtat e garantuara kushtetuese, atëherë edhe mbështetja në **stare decisis** të **Gjykatës së Strasburgut** nuk mund të ketë asnjë kuptim.

Në vendimin për vënien e masës së përkohshme nuk mund të ketë **mendim mospajtues** apo **konkurrues**.[109] Kjo për shkak të faktit të thjeshtë se objekt i vendimit për vënien e masës së përkohshme të mbrojtjes nuk është çështja meritore, por një akt juridik apo një situatë jetësore që potencialisht mund të prodhojë rrezik për shkaktim të dëmeve të pariparueshme ndaj individit apo dëmtim të interesit publik.

Bazuar në jurisprudencën e **GJEDNJ**, lejueshmëria e kërkesës për masë të përkohshme dhe caktimi i saj me një vendim të posaçëm jo domosdo duhet të koincidojnë. Kjo dëshmohet lehtë nëse shikohet se si kanë përfunduar vendimet për masat e përkohshme të shqiptuara nga **GJEDNJ**, përkatësisht nga organet e autorizuara prej saj:[110] mbi 55 për qind e rasteve në të cilat është lejuar masa e përkohshme e mbrojtjes, në fund janë shpallur si të palejueshme. Një gjë e tillë ka ndodhur për shkak se shtetet përgjegjëse kundër të cilave janë vënë masat e përkohshme, të cilat ato i kanë zbatuar në të shumtën e rasteve me përpikëri, në ndërkohë kanë arritur të provojnë mjaftueshëm se kërkesat mbi të cilën ishin vënë masat nuk mund të kalonin testin e lejueshmërisë për shqyrtim dhe vendosje meritore të rastit kryesor.[111]

Këtë frymë dhe këtë logjikë e ka ndjekur edhe redaktimi i dispozitave të rregullit 57.4 si më sipër të **RP**: nga formulimi i kësaj dispozite qartë shihet se ka një dallim substancial në mes të lejueshmërisë së kërkesës dhe caktimit të masave të përkohshme, pa përmendur këtu dallimin akoma më të madh në mes të meritave të rastit dhe vënies së masave të përkohshme. Pikërisht për këtë arsye, njëjtë si në jurispru-

---

109 Në praktikën e **Gjykatës Kushtetuese**, për fat të keq, ka pasur një rast të tillë të shëmtuar. Në rastin e njohur si rasti i Radio Televizionit të Kosovës (**RTK)**, gjyqtarët **Almiro Rodrigues** dhe **Gjyljeta Mushkolaj** patën paraqitur mendimet e tyre mospajtuese. Rasti i **RTK**-së ka qenë rasti i parë në historinë e Gjykatës Kushtetuese, i cili në kabllogramet e **WikiLeaks** u pat cilësuar si versioni kosovar i **Marbury vs. Madison.** Cf. *Viewing cable 10 Prishtina 84. U.S. Embassy in Pristina. Subject: Kosovo Celebrates Second Anniversary with Sucess and Challenges. Date: 2010-02-17.* (seksioni me titull "Importance of the Rule of Law"). Në internet: http://wikileakscablegate.blogspot. com/2010 /12/vieëing-cable-10pristina84-kosovo.html (shikuar në janar 2019).
Në mendimin e vet mospajtues, gjyqtari **A. Rodrigues** ka theksuar se masat e përkohshme nuk kanë natyrë autonome dhe se duhet çdoherë të caktohet pas konstatimit të lejueshmërisë së kërkesës (parag. 1 & 17); përveç kësaj, ky gjyqtar mendon se këto masa vendosen **ex officio,** kur ka një interes publik kurse sipas kërkesës së palës kur ka rrezik për cenim të një interesi privat (parag. 42), gjë që nuk është e vërtetë sepse masat e përkohshme të mbrojtjes kanë për qëllim primar sigurimin e integritetit të gjykimit konkret dhe ruajtjen e të drejtave të palëve në procedurë) . Cf. më shumë në **Rasti KI 19/09. Tomë Krasniqi vs. RTK dhe KEK. Mendim Mospajtues: Almiro Ridrigues, Datë: 19 tetor 2009.**
Mendimi mospajtues i gjyqtares **Gj. Mushkolaj** është edhe më skandaloz sepse në tërësi flet për meritat e rastit, duke mbrojtur idenë se **RTK** ka të drejtë të financohet nga 3.5 euro e taksave të qytetarëve, të vëna njëanshëm dhe të inkasuara përmes faturave të **KEK.** Për këtë, kjo gjyqtare thërret në ndihmë të **drejtën e butë** të **KE** dhe të **BE**, përkatësisht disa rekomandime dhe rezoluta që flasin për mënyrën e financimit në **Evropë** të transmetuesve publik. Jo vetëm kaq: kjo gjyqtare citon një autor të huaj dhe një raport apo analizë me qëllim të provimit të kauzës së saj sikur gjoja ka mbështetje në të drejtën e huaj. Sikundër dihet, Gjykata Kushtetuese në këtë lëndë fare nuk ka vendosur për meritat e rastit. Në të vërtetë, Gjykata në mënyrë shprehëse ka argumentuar se këtu nuk bëhej fjalë për vendosje meritore të rastit dhe se fjala ka qenë për një lëndë ku **prima facie** kishte ndodhur viktimizimi i paraqitësit të anekses kushtetuese, pensionistit **Tomë Krasniqi**. Cf. më shumë në mendimin mospajtues të gjyqtares në fjalë, tri faqe vetëm, **Rasti KI 19/09. Tomë Krasniqi vs. RTK dhe KEK. Mendim Mospajtues: Gjyljeta Mushkolaj. Datë: 23 tetor 2009.**

110 Sipas redaktimit të paragrafit të parë dhe të katërt të rregullit 39 ["Masat e përkohshme"] të RP të **GJEDNJ** del se dhoma apo, kur kjo shihet si e arsyeshme, kryetari i dhomës ose gjyqtari në detyrë (më të cilin nënkuptohet zëvendës kryetari i dhomës) mund të urdhërojnë vënien e masave të përkohshme të mbrojtjes.

111 Hannah R. Garry, "When Procedure Involves Mattwers of Life and Death: Interim Measures and the European Convention on Human Rights". *Euroepan Public Law* Vol. 7 Issue 3 (September 2001) fq. 399-432, në fq. 410 & 421; Cf. Po ashtu edhe Alastair Mowbray, "A New Strasbourg Approach to the Legal Consequences of Interim Measures". *Human Rights Law Review* Vol. 5 No. 2 (2005) fq. 377-386 (autori sqaron se në rastin **Mamatkullov and Askarov vs Turkey**, të cilin e diskutojmë në vijim, **GJEDNJ** ka luajtur rolin e normëvënësit sepse nuk ka ekzistuar një vullnet ndër shtetet anëtare të **KEDNJ** për të njohur natyrën e detyrueshme masave të përkohshme, të cilat tanimë ishin bërë praktikë rutinë dhe po viheshin në jetë nga shtetet në të shumtën e rasteve; po ashtu, autori ven në dukje dallimin më mes të të drejtave procedurale dhe atyre materiale të garantuara më KEDNJ; dhe, së fundi, autori thekson se masat e përkohshme mund të vihet edhe para së të filloj shqyrtimi i çështjes kryesore dhe pa marrë parasysh nëse kërkesa kryesore është e lejueshme ose jo).

dencën e **GJEDNJ**, nga pala kërkohet që **prima facie** të dëshmoj lejueshmërinë e kërkesës.[112] Dhënia e përparësisë provimit të lejueshmërisë së kërkesës kundrejt provimit të meritave të saj përbën, në thelb, esencën e masave të përkohshme. Kjo është kështu si pasojë e faktit se, në praktikën evropiane, objekt i masave të përkohshme kanë qenë kryesisht ndalimi i depërtimit apo ekstradimit dhe siguria e jetës dhe lirisë së individit. Shikuar nga ky kënd, masat e përkohshme në nivel evropian kanë luajtur një rol vital në shmangien e situatave që do të pengonin **GJEDNJ** për të shqyrtuar kërkesat siç duhet dhe, sipas nevojës, për të siguruar që pala kërkuese do të ketë mundësi për të shfrytëzuar dobitë efektive dhe praktike të lirive dhe të drejtave të garantuara me Konventë.[113] Ndryshe nuk mund të ruhet integriteti i gjykimit të nisur, lëre më të bëhet fjalë për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Kjo rrethanë shpjegon edhe faktin se vënia e masave të përkohshme mund të bëhet edhe përmes urdhrit verbal të cilin kryetari i **GJEDNJ** ua komunikon palëve, shtetit përgjegjës dhe palës që ka kërkuar masën e përkohshme. Në vijim të kësaj, po ashtu vlen të theksohet se masa e përkohshme në praktikën e **Strasburgut** ka mund t'i drejtohet edhe vetë palës që kërkon masën e tillë, me kërkesë që e njëjta të mos veproj asgjë në kundërshtim me masën e vënë, p.sh. që mos të largohet nga vendi deri të vendoset për rastin meritorisht. Dy këto aspekte qartë shkojnë në favor të tezës se lejueshmëria e masës, jo e meritave të kërkesës bazike, përbën esencën e veprimit të **GJEDNJ** me rastin e caktimit të masave të përkohshme.

Nga ky shtjellim si më sipër qartë shpërfaqen modalitete e veprimit të arsyeve të vendimit për vënien e masave të përkohshme: **radio decidendi** i një vendimi për masën e përkohshme nuk ka ndonjë relevancë për vendimmarrjen e mëpastajme të Gjykatës në sferën e vënies së masave të përkohshme. Ky, megjithatë, nuk është rasti kur bëhet fjalë për **stare decisis** me origjinë nga **GJEDNJ**: në këtë rast, Gjykata Kushtetuese ka detyrim të njëjtë kushtetues nga si me vendimmarrjen meritore, për aq sa vendimi për masën e përkohshme afekton (prek) liritë dhe të drejtat e garantuara kushtetuese. Një situatë e tillë nënkupton që këtu vjen në shprehje zbatimi i plotë i detyrimit kushtetues nga neni 53 i Kushtetutës. Kjo përfshinë edhe vetë formën e vendimit për masën e përkohshme: për shkak të urgjencës, ai mund të ketë edhe formën verbale, njëjtë siç ndodhë në praktikën e **GJEDNJ.**[114] I kuptuar kështu, **stare decisis** i jep kuptim dhe përmbajtje konkrete **efekteve të përgjithshme** të vendimit mbi vënien e masave të përkohshme, pa marrë parasysh formën e tij: efektet nga neni 116.1 i Kushtetutës njëjtësohen me **stare decisis** për aq sa afektojnë (prekin) liritë dhe të drejtat e garantuara me Kushtetutë. Në të gjitha rastet tjera, vendimi për vënien e masës së përkohshme nuk mund të ketë statusin e një **stare decisis.** Ky, siç mund të vërehet, nuk është rasti me **efektin e përgjithshëm** të vendimeve sipas nenit 116.1 të

---

[112] Deri në momentin e shkrimit të këtyre rreshtave (janar 2017), në **Gjykatën Kushtetuese** ka pasur vendime për 25 masa të përkohshme, përfshirë këtu edhe vendimet për vazhdimin e tyre. Të gjitha këto janë bërë në formën me shkrim, sipas kërkesave së rregullit 56.2 ["Kërkesa për masë të përkohshme"] të **RP**. Vetëm në një rast, masa e përkohshme është urdhëruar nga Gjykata në formën gojore. E kemi fjalën për rastin **KI 121/10**, që diskutohet në vijim. Arsyeja për dhënien e urdhrit me gojë për vënien e masës së përkohshme ka qenë për shkak se ekzistonte rreziku real i depërtimit / dëbimit të palëve që kërkonin **masën e përkohshme**, të cilët ishin shtetas të huaj. Së bashku me rastin **KI 121/10**, bëhen gjithsej 28 raste të vendimeve për vënien apo vazhdimin e masave të përkohshme. Mbi 60 për qind e tyre kanë qenë vendime për lejimin e masave të përkohshme apo vazhdimin e tyre. Në të gjitha rastet e vënies së tyre, **Gjykata Kushtetuese** ka theksuar në mënyrë specifike se vendimi nuk paragjykon lejueshmërinë e kërkesës themelore, përkatësisht se vënia e masave të përkohshme të mbrojtjes nuk paragjykon **themeltësinë e meritave** të rastit. Një qasje e tillë është krejtësisht standard dhe sipas rregullave të profesionit sepse, siç konstatohet nga ne në këtë seksion, roli i masave të përkohshme është pengimi i krijimit pa kthim të situatave të dëmshme për palët apo interesin publik që do të çonte në cenimin e integritetit të gjykimit përfundimtar të meritave të rastit. Një cenim i tillë i integritetit të gjykimit përfundimtar të meritave të rastit mund të rezultojë në shkeljen e disa të lirive dhe të drejtave të garantuara në nivel nacional dhe ndërkombëtar. Ndër to më së shpeshti përmenden e drejta për gjykim të lirë dhe të drejtë, mohimi i të drejtës për përdorim të mjeteve juridike efektive dhe për vetë qasjen në gjykatë.

[113] William A. Schabas, *The European Convention on Human Rights.A Commentary* (Oxford University Press: Oxford, 2015) fq. 749.

[114] Sipas rregullit 56.2 ["Kërkesa për masë të përkohshme"] të RP, kërkesa për caktimin e masës së përkohshme duhet të bëhet me shkrim. Në praktikën e **Gjykatës Kushtetuese**, megjithatë, ka pasur rast kur ky nuk ka qenë rasti: në rastin **KI 121/10** që ka pasur të bëj me **depërtimin e shtetasve të huaj** nga Kosova, Gjykata në mënyrë **verbale** pat lëshuar urdhrin për ndalim të depërtimit deri të vendosej për lejueshmërinë e kërkesës bazë të aplikantëve. Atë urdhër e ka përçuar vetë Kryetari i Gjykatës, autori i parë i librit, drejtuar organeve kompetente të vendit. Cf. *Rasti KI 121/10. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Sitaram Chaulagai, Krishna Bandur Chamlagai, Chandra Kala Chauhan, dhe Hom Bahadur Battarai. Vlerësim i kushtetutshmërisë se vendimeve te Gjykatës se Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë GJL. nos. 1258/2010, 1259/2010, 1260/2010, 1261/2010, të 22 nëntorit 2010.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtinë: 14 dhjetor 2011. Nr. ref.: RK177/11. Parag. 5, 9 & 58.

Kushtetutë. E thënë në mënyrë tjetër, veprimi horizontal dhe vertikal i vendimit për masat e përkohshme jo çdoherë njëjtësohet me efektin e përgjithshëm të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në kuptim të nenit 116.1 të Kushtetutës: i tillë është rasti vetëm atëherë kur vendimi në fjalë afekton (prek) liritë dhe të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe vetëm sa i përket **stare decisis** me origjinë nga **GJEDNJ:** zgjidhjet kushtetuese, ligjore dhe ato të reflektuara në rregullativën e brendshme të **Gjykatës Kushtetuese**, të cilat u shtjelluan deri këtu, duhen interpretuar në këtë kuptim.

T'i kthehemi tani zgjidhjeve dhe përvojave krahasuese me gjyqësinë kushtetuese në sferën e masave të përkohshme, përfshirë këtu kuptimin, origjinën dhe zhvillimin e tyre. Ky shtjellim në veçanti ka parasysh jurisprudencën e **GJEDNJ**, gjë që është e kuptueshme nëse merret parasysh detyrimi kushtetues nga neni 53 i Kushtetutës. U mor vesh, gjithnjë në dritën e trajtimit të **stare decisis** në Kosovë. Ekzistojnë edhe tri arsye shtesë që mbështesin këtë qasje dhe kryesisht lidhen me gjenezën e lindjes së masave të përkohshme në jurisprudencën e **GJEDNJ**, me vetë kuptimin dhe natyrën e tyre juridike. Të shohim nga afër përmbajtjen e këtyre arsyeve.

Arsyeja e parë për një qasje krahasuese qëndron në faktin se në përvojën me gjyqësinë kushtetuese kosovare ekziston vetëm një rast ku Gjykata ka marrë vendim për vënien e masës së përkohshme duke argumentuar me precedentet e **Gjykatës së Strasburgut**. Në këtë Gjykatë, instituti juridik i masës së përkohshme ka gjetur një vend meritor dhe ka shërbyer dhe shërben si një mjet i fortë për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut të garantuara me **KEDNJ**. E kemi fjalën për rastin e sipërcekur të **RTK**-së.[115] Këtu Gjykata Kushtetuese ka vënë në dukje se pala kërkuese ka dëshmuar se ishte viktimë **prima facie** dhe se fjala ka qenë për interes publik, jo për ndonjë interes privat. Ky rast ka pasur të bëjë me pagesën në dobi të **RTK** të një takse prej 3.5 eurove në muaj për një ekonomi shtëpiake. Gjykata ka cituar rastet e **Gjykatës së Strasburgut** për të dëshmuar dy aspekte të vendimit për vënien e masës së përkohshme: në rend të parë, ajo ka dëshmuar se pala ankuese ishte **prima facie** një viktimë e taksës prej 3.5 eurove në muaj në favor të **RTK** dhe, së dyti, se kërkesa nuk ishte një **actio popularis**, por një kërkesë që kishte për objekt shqyrtimi një interes publik (taksën e vënë njëanshëm prej 3.5 euro në favor të **RTK**).[116]

Në vijim sa më sipër, arsyeja e dytë, e cila qëndron në lidhje të ngushtë me të parën, ka të bëjë me origjinën e çuditshme të lindjes së institutit të masave të përkohshme: vetë **KEDNJ** nuk flet për institucionin e masës së përkohshme. Në kohën e draftimit dhe miratimit të saj del se nuk ka pasur asnjë diskutim serioz nga ana e shteteve anëtare të **KE** me qëllim të futjes së masave të përkohshme si një instrument juridik në kuadër të sistemit evropian për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut.[117] Ky instrument, si i tillë, ka lindur dhe është zhvilluar nga nevojat e jetës për të mbrojtur dhe siguruar liritë dhe të drejtat e njeriut nga veprimet e ngutshme, arbitrare dhe të padrejta të autoriteteve publike të vendeve anëtare të **KE-së**. Kjo gjë dëshmohet me vetë arsyet dhe mënyrën se si është marrë vendimi i parë që ka cilësuar si të detyrueshme për shtete palë të **KEDNJ** vendimin për vënien e masave të përkohshme.

---

115 Cf. fusnota nr. 109, **supra,** në këtë seksion, dhe komentet tona lidhur me të.

116 *Rasti KI 11.09. Vendim. Masë e Përkohshme*. **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS.** Prishtinë. Datë: 16 tetor 2009. Akti Nr. MP-01/09, fq. 3-4.

117 R. St. J. Maçdonald, "Interim Measures in International Law, with Special Reference to the European System for the Protection of Human Rights". 52 *Max-Planck-Institut für ausländisches öffentliches Recht und Völkerrecht* (1992) fq. 703-740 në fq. 713 (ku autori sqaron se shtetet nuk kanë pasur vullnet që të fusin as në KEDNJ, por as në protokollet dhe dokumentet tjera të drejtën e **GJEDNJ** për të vënë masat e përkohshme; ky diskutim i shteteve ka pasur të bëjë me sferën penale, përkatësuisht me ekstradimin dhe vënien e masave në një hap të tillë, kurse në materien civile shumë më pak); Hannah R. Garry, "When Procedure Involves Mattwers of Life and Death: Interim Measures and the European Convention on Human Rights", 407-409 (ku autori në fillim tregon se në draftin e 12 korrikut 1949 të **KEDNJ** ka ekzistuar një dispozitë e qartë lidhur me masat e përkohshme, tërësisht identike me atë që ekziston në nenin 41 të **Statutit të GJND**-së; kjo draft-dispozitë, megjithatë, nuk u miratua; autori tregon se arsyeja për një gjë të tillë ka qenë fakti se shtetet në pjesën dërrmuese të rasteve kanë vënë në jetë kërkesat jo formale të **Komisionit për të Drejtat e Njeriut** për zbatim të masave të përkohshme; kjo gjendje ka qenë inkurajuese, ashtu që në vitin 1974 u bë kodifikimi, me nxjerrjen e rregullës 36, e cila formalisht sanksionoi të drejtën e Komisionit për vënien e masave të përkohshme çdoherë kur një gjë e tillë është në interesin e palëve ose të vazhdimit të procedurave gjyqësore pranë tij; këto masa mund t'i vejë, sipas kësaj rregulle, Komisioni ose vetë Presidenti kur Komisioni nuk është në seancë). Rregulla 36 e Komisionit korrespondon me rregullën 39 të **RP** të **GJEDNJ.**

Deri në rastin e njohur si **Mamatkulov and Askarov vs. Turkey**, masat e përkohshme të mbrojtjes të vëna nga **Gjykata në Strasburg** nuk konsideroheshin si të detyrueshme për t'u respektuar nga shtetet anëtare të **KE**-së.[118] Ato më shumë konsideroheshin si një mekanizëm procedural, si një teknikë juridike që kishte për qëllim ruajtjen e barazisë së palëve në procedurë dhe ruajtjen e integritetit të vendimit përfundimtar lidhur me rastin. Nga rasti i sipërcekur e tutje, masat nisin të konsiderohen si një institut serioz në duart e **GJEDNJ** me qëllim të mbrojtjes efektive të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe, për pasojë, si një institut me natyrë mandatore për shtetin të cilit i adresohen (shteti përgjegjës kundër të cilit janë vënë).

Futja e masave të përkohshme në sistemin evropian të drejtësisë ka ndodhur, sikundër shihet, jo përmes stipulimit të tyre në dispozitat e **KEDNJ** por përmes praktikës gjyqësore të **Strasburgut**. Edhe atëherë kur ndodhi sanksionimi i tyre juridik, një gjë e tillë pati një status shumë të ulët normativ: ato u vendosën në gjirin e rregullativës së brendshme të brendshme të **GJEDNJ**, përkatësisht në dispozitat e rregullit 39 ["Masat e Përkohshme"] të **Rregullave** të Procedurës (RP). Kjo rrethanë, megjithatë, nuk ka qenë pengesë për t'i shndërruar dispozitat e këtij rregulli në një normë juridike të barasvlershme me secilën normë të **KEDNJ**. Thënë me fjalë të tjera, instituti i masave të përkohshme paraqet një krijesë të praktikës gjyqësore, jo një aktivitet normativ të vendeve anëtare të **KE**. Kjo ka ndodhur si rezultat i interpretimit konstruktiv të rregullit 39 si më sipër të **RP** të **GJEDNJ**, duke e barazuar këtë rregull me normat e **KEDNJ**, proces që ka rezultuar në shndërrimin e institutit të masave të përkohshme të mbrojtjes në një mjet shumë efektiv për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut në Evropë.[119]

---

[118] Ky ka qenë rasti i parë që **GJEDNJ** vendosi se masat e përkohshme kishin natyrë juridike të një detyrimi autonom të cilin shtetet anëtarë të **KEDNJ** duhej ta vinin në jetë si të tillë. Me këtë rast u definua edhe kuptimi i masave të përkohshme: ato paraqesin urdhra të gjykatës në rastet kur vlerësohet se ekziston rreziku nga një dëmi të pariparueshëm për të drejtat e njërës prej palëve; kjo rrethanë imponon nevojën e ruajtjes së **status quo**-s së objektit të gjykimit deri në vendimin përfundimtar të gjykatës lidhur me të drejtat dhe detyrimet e palëve në gjykim. Cf. **ECtHR**. **Case of Mamatkulov and Askarov v. Turkey** (Applications nos. 46827/99 and 46951/99). Judgement. **Strasbourg** . 4 February 2005. Paras. 108 & 113.
Këto dy cilësi, mundësia për shkaktim të dëmit të pariparueshëm dhe ruajtja e **status quo**-s së objektit të gjykimit, paraqesin esencën e natyrës juridike të masave të përkohshme: ato, sikundër u vërejt më sipër, përbëjnë një detyrim tjetër autonom, krejtësisht të pavarur nga detyrimi bazik (themelor) që mund të ekzistojë i mishëruar në kërkesën e parë për mbrojtje juridike. Shikuar në këtë kuptim, shkelja e këtij detyrimi, e detyrimit për zbatim të masës së përkohshme, shërben si një bazë e re juridike për nisje të procedurave gjyqësore për cënim të së drejtës për qasje në gjykatë nga neni 34 ["Aplikimi individual"] i **KEDNJ.** Cf. Yves Haeck, Clara Burbano Herrera and Leo Zwaak, "Strasbourg's Interim Measures Under Fire: Does the Rising Number of State Incompliances with Interim Measures Pose a Threat to the European Court of Human Rights?" *European Yearbook on Human Rights*, Vol. 11 (March 1, 2011) fq. 375-403, në fq. 378-379; Pieter van Dijk, Fried van Hoof, Arjen Van Rijn, Leo Zwaak (eds.)., *Theory and Practice of the European Convention on Human Rights: Fourth Edition. Fourth Edition*, fq. 110-113; William A. Schabas, *The European Convention on Human Rights.A Commentary*, 750-751.
Në të drejtën moderne, kjo që u tha më sipër vlen, në parim, për të gjitha llojet e procedurave gjyqësore dhe kuazi-gjyqësore. Në këtë kontekst, në literaturë janë vërejtur dy funksione që i kryejnë masat e përkohshme të mbrojtjes: funksioni parësor i masave të përkohshme apo mbrojtëse është, **grosso modo**, ruajtja e integritetit të gjykimit përfundimtar dhe pengimi i arbitraritetit në procesin e realizimit gjyqësor të të drejtave. Cf. Lawrence Collins, "Provisional and protective peasures in international litigation". *Recueil des cours. Académie de droit international de La Haye* Vol. 234 No 3 (1992), fq. 9-238 në fq. 23.
Interesi i palëve në procedurë dëmtohet nga shkaktimi i dëmit të pariparueshëm, apo nga mundësia potenciale për shkaktim të një dëmi të tillë, gjë që rrënon integritetin e gjykimit konkret. Dëmi jo domosdo duhet të ketë ndodhë për të aktivizuar të drejtën për qasje në **GJEDNJ:** sikundër u tha, vetë fakti i moszbatimit të masës së përkohshme të vënë nga ana e **GJEDNJ** përbën bazë të re për palën për të paraqitur kërkesë për cenim të nenit 34 të **KEDNJ**. Kjo përbën një të drejtë autonome dhe të pavarur nga e drejta bazë (themelore) që ka shërbyer si bazë për vënien e masës së përkohshme të mbrojtjes. Ai dëm mund të mos ketë ndodhur fare, e megjithatë shteti kundër të cilit është vënë masa e përkohshme të konsiderohet përgjegjës për cenim të nenit 34 të **KEDNJ.** Në të njëjtën mënyrë, **mutatis mutandis**, moszbatimi i masës së përkohshme të vënë nga ana e **GJEDNJ** mund të shërben si bazë për cenim të secilës të drejtë materiale të përcaktuar nga **KEDNJ** dhe për të cilën është paraqitur kërkesa themelore (bazë), siç janë, ta zëmë, e drejta për jetë, e drejta për mbrojtje familjare, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm etj. Kjo qasje është rrënjosur thellë në praktikën e **GJEDNJ** dhe me shumë kujdes është evidentuar nga doktrina juridike. Cf. Yves Haeck, Clara Burbano Herrera and Leo Zwaak, "Strasbourg's Interim Measures Under Fire: Does the Rising Number of State Incompliances with Interim Measures Pose a Threat to the European Court of Human Rights?, fq. 377-378.

[119] Laurence Burgorgue-Larsen, "Interim measures in the European system of Human Rights. *Inter-American and European Human Rights Journal* Vol. 2 No. 1-2 (2009), fq. 99-118, në versionin në internet, në 8, në veçanti fusnotat nr. 40-43 dhe tekstin që i shoqëron. Në https://www.pantheonsorbonne.fr/fileadmin/IREDIES/ Contributions _en _ ligne/L._BURGORGUE-LARSEN/MesuresprovisoiresING-LBL.pdf (shikuar në janar 2019).

Kjo si më sipër nënkupton që cenimi i institutit të masave të përkohshme përbën në vetvete një cenim të normave të **KEDNJ**, pa marrë parasysh nëse ka ardhur deri të shkaktimi i dëmit: vetë fakti i moszbatimit të masave të përkohshme përbën një pengesë serioze për palën dhe të drejtën e saj për të ushtruar në mënyrë efektive të drejtën në kërkesë individuale nga neni 34 ["Aplikimi Individual] i **KEDNJ**. Kjo është kështu nisur nga fakti se, në përgjithësi, aktualisht pranohet se vënia e masave të përkohshme përbën një tagër imanent që mishërohet në vetë natyrën e funksionit gjyqësor. Si i tillë, ky tagër paraqet një kusht të domosdoshëm për efektivitet të mbrojtjes gjyqësore të lirive dhe të drejtave të njeriut të garantuara me dokumente dhe instrumente kryesore ndërkombëtare.[120] E njëjta vlen, **mutatis mutandis**, edhe për gjyqësinë nacionale, përfshirë këtu gjyqësinë kushtetuese dhe efektivitetin e saj.

Nga shtjellimi si më sipër del se për autoritetet publike në **Kosovë** mbështetja në precedent e **GJEDNJ** me rastin e vendosjes mbi caktimin e masave të përkohshme, duke përdorur ato si bazë analitike dhe argumentuese për vendimmarrje, përbën një detyrim kushtetues që ankorohet në nenin 53 të Kushtetutës, njëjtë si me vendimmarrjen meritore, për aq sa vendosja e tyre afekton (prek) liritë dhe të drejtat e njeriut të garantuara me Kushtetutë. Kjo në veçanti vlen për **Gjykatën Kushtetuese**. Kjo është kështu sepse, nga shtjellimi si më sipër, u pa qartë se standardet e vënies së masave të përkohshme janë përcaktuar nga praktika gjyqësore mbi bazën e interpretimit konstruktiv të rregullativës së brendshme të **GJEDNJ**. Me fjalë të tjera, këtu më nuk bëhet fjalë për një rregullativë të brendshme të **GJEDNJ**, por për një praktikë që ka transformuar këtë rregullativë të brendshme duke e bërë të barasvlershme me normat e **KEDNJ**. Nga ky këndvështrim, precedenti i **GJEDNJ** në lidhje me masat e përkohshme përbën një detyrim kushtetues në kuptim të nenit 53 të Kushtetutës së vitit 2008, gjë që nënkupton detyrimin e **Gjykatës Kushtetuese** dhe autoriteteve tjera publike në Kosovë për të vënë në jetë precedentët e **Strasburgut** që i referohen kushteve për vënien e masave të përkohshme. Kjo është kështu nisur nga fakti se dispozita kushtetuese e nenit 53 të Kushtetutës nuk saktëson se për cilat lloje të vendimeve të **GJEDNJ** bëhet fjalë: ajo dispozitë flet, thjeshtë, për detyrimin kushtetues të të gjitha autoriteteve publike në Kosovë për të vënë në jetë precedentet e **Gjykatës së Starsburgut** të krijuara gjatë interpretimit të saj të dispozitave të **KEDNJ**. Kjo përfshinë edhe precedentin e krijuar gjatë interpretimit të rregullativës së brendshme të **GJEDNJ**, nisur nga fakti se e njëjta, përmes interpretimit konstruktiv në rastin e sipërcekur kundër **Turqisë**, është shndërruar në një normë të barabartë me normat tjera të **KEDNJ** me qëllim që të shërbejë si një mekanizëm për mbrojtjen efektive të lirive dhe të drejtave të njeriut të garantuara me **KEDNJ**. Kjo rrethanë e bënë, përtej çdo dyshimi, **stare decisis** të **GJEDNJ** në lëmin e masave të përkohshme një standard që vlen dhe duhet të ndiqet në Kosovë çdoherë kur vendoset për liritë dhe të drejtat e garantuara kushtetuese. I kuptuar në këtë mënyrë, precedenti përfshinë përdorimin e **radio decidenti** nga ana e autoriteteve publike kosovare të **res judicata** dhe **res intepretationis** të prodhuar nga **GJEDNJ** me rastin e vendosjes dhe administrimit të institutit të masave të përkohshme të mbrojtjes.

Arsyeja e tretë dhe e fundit që flet në favor të qasjes krahasuese nga ana e jonë ka të bëjë me faktin se instituti i masave të përkohshme ka hyrë në analet e **GJEDNJ** përmes zgjidhjeve normative dhe praktikës së **GJND**.[121] Ky institut sot ka një aplikim të gjerë në të gjitha llojet

[120] Jo M. Pasqualucci, " Interim Measures in International Human Rights: Evolution and Harmonization". *Vanderbilt Journal of Transantional Law* Vol. 38 No. 1 (Jnauary 2005) fq. 1-49, në fq. 13-14; Ngjashëm edhe Alastair Mowbray, "A New Strasbourg Approach to the Legal Consequences of Interim Measures", fq. 382-383 (autori thekson se efektiviteti i mjeteve juridike në kuptim të nenit 13 të **KEDNJ** kërkon ekzistimin e një mjeti të aftë për të penguar ekzekutimin e vendimeve apo ndërmarrjen e veprimeve që janë në kundërshtim me **KEDNJ** dhe potencialisht të pakthyeshme; për këtë arsye, nuk ka nevojë që të parashikohet një tagër i tillë në mënyrë shprehimore sepse nënkuptohet se mbrojtja efektive e lirive dhe të drejtave të garantuara me **KEDNJ** përbën objektin dhe qëllimin e saj; fundja këtë të drejtë e kanë gjykatat vendore, pse nuk duhet ta ketë **GJEDNJ**, pyet autori).

[121] William A. Schabas, *The European Convention on Human Rights.A Commentary*, 749.

e gjyqësisë ndërkombëtare, përfshirë këtu arbitrazhin.[122] Për këtë shkak, njohja e zgjidhjeve normative dhe e vetë praktikës së **GJND** në këtë lëmi paraqitet si e domosdoshme: ato zgjidhje dhe ajo praktikë, në mënyrë të tërthortë, përmes jurisprudencës së **GJEDNJ**, duhet të vihen në jetë nga autoritetet publike kosovare, përfshirë Gjykatën Kushtetuese, në rastet kur vendosin për masat e përkohshme duke u bazuar në analizën dhe argumentimin e precedenteve të **GJEDNJ** në lëmin e vendimmarrjes dhe administrimit të masave të përkohshme ndaj shteteve sovrane dhe të pavarura palë të **KEDNJ**. U mor vesh, çdoherë bëhet fjalë për precedentet që kanë afektuar (prekur) liritë dhe të drejtat e garantuara ndërkombëtarisht, jo për praktikën dhe zgjidhjet tjera normative të **GJND**-së.

Nga tërë kjo vërehet se elementet definuese të konceptit të masave të përkohshme në Kushtetutë, **Ligjin nr. 03/L-121** dhe në **RP** janë të njëjta me elementet standarde të këtij koncepti në teorinë dhe praktikën e vendeve të tjera dhe në të drejtën ndërkombëtare. Ajo që nuk u diskutua këtu ka të bëjë me marrëdhënien e institutit të masave të përkohshme në sistemin kushtetuese kosovar me të drejtën për gjykim në kohë të arsyeshme dhe mbrojtje efektive gjyqësore të lirive dhe të drejtave të garantuara me **KEDNJ.** Përkundër faktit që **GJEDNJ** asnjëherë nuk ka gjetur cenim të nenit 6.1 ["E drejta për gjykim të drejtë"] të **KEDNJ** në rastet kur sistemi juridik i brendshëm nuk i ka dhënë palës mundësinë për vënien e masës së përkohshme, në literaturë me të drejtë është vënë në dukje se gjykimi në kohë të arsyeshme nga neni 6.1 në lidhje me mbrojtjen efektive gjyqësore të lirive dhe të drejtave njerëzore nga neni 13 ["E drejta për mjet efektiv"] i **KEDNJ** i detyron shtetet anëtare të **KE** që t'u japin individëve dhe personave juridik të drejtën për vënien e masave të përkohshme të mbrojtjes gjyqësore.[123] Arsyet për një gjë të tillë janë të njëjta me ato që u zunë në gojë më sipër dhe që kanë çuar deri te lindja e praktikës së masave të përkohshme në gjirin e **GJEDNJ**. Sabotimi në nivel nacional i kërkesës së palës për vënien e masave të përkohshme të mbrojtjes paraqet mohim të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sepse e len palën të zvarritet nëpër gjykata pa nevojë. Kjo përfshinë edhe procedurat para Gjykatës Kushtetuese. Përveç cenimit të nenit 6.1 të **KEDNJ**, mohimi i vënies së masave të përkohshme të mbrojtjes paraqet edhe cenim të së drejtës për mjet efektiv juridik nga neni 13 i **KEDNJ**, për shkak se çdo mohim pa arsye i kërkesës për masë të përkohshme çon domosdo në lëndimin e integritetit të gjykimit dhe vendosjes së rastit, duke e bërë të paobjekt vendimin meritor.

13.3.2. Caqet e *stare decisis* në pranueshmërinë e kërkesës

Parametrat e vlerësimit të pranueshmërisë së një kërkese janë parametra kryesisht të natyrës procedurale, të cilët gjenden në tekstin kushtetues, në ligje dhe në rregullativën e brendshme të **Gjykatës Kushtetuese**. Në të gjitha rastet bëhet fjalë për vlerësimin e aspekteve jomeritore, përkatësisht për vlerë-

---

[122] Koncepti i masave të përkohshme apo mbrojtëse në të drejtën ndërkombëtare është deklaruar të jetë si një parim i përgjithshëm i përbashkët për të gjithë popujt e civilizuar, në kuptim të nenit 38 (1) nën "c" të Statutit të **GJND**-së. Cf. **International Court of Justice, Agean Sea Continental Shelf Case**, **Greece vs. Turkey**, *ICJ Reports* 1976, 3, para. 15; Për vënien e tyre, në jurisprudencën e **GJND** kërkohet që të plotësohen tri kushte: e para, që të dëshmohet në shikim të parë se çështja bie në juridiksionin material të **GJND**-së; e dyta, që situata të kërkoj vëmendje urgjente; dhe, e treta, që të ekzistoj një rrezik (apo gjase e madhe) për shkaktim të dëmit të pariparueshëm të të drejtave të palëve nëse nuk vihet masa e përkohshme.
Lidhur me juridiksionin ndaj çështjes kryesore që është objekt gjykimi, vlen të theksohet se në pjesën dërrmuese të rasteve të vendosura meritorisht nga **GJND** nuk kërkohet që në mënyrë përfundimtare të vendoset për juridiksionin ndaj objektit të gjykimit: mjafton që **GJND** të kënaqet me faktin se mungesa e juridiksionit nuk është e hapur. Cf. Patricia A. Essoff, "Finland v. Denmanrk: A Call to Clarify the International Court of Justice's Standards for Provisional Measures". *Fortham International Journal Law Journal* Vol. 15 Issue 3 (1991) fq. 839– 878 në. fq. 844-853; Michael K. Addo, "Interim Measures of Protection for Rights Under the Vienna Convention on Consular Relations". *European Journal of International Law* Vol. 10 No 4 (1999) fq. 713-732, në fq. 717.

[123] Susana de la Sierra, "Provisional Court Protection in Administrative Disputes in Europe: The Constitutional Status of Interim Measures deriving from the right to Effective Court Protection. A Comparative Approach". *European Law Journal* Vol 10 No. 1 (2004) fq. 42-60 në fq. 48; Më vonë, në vitin 2008, kjo qasje teorike është konfirmuar nga vetë **GJEDNJ** me vendimin e saj në rastin e njohur Micallef. Cf. Grand Chamber. **ECtHR Case of Micallef v. Malta** (Application no. 17056/06) **Judgement**. Strasbourg, 15 October 2009.

simin nëse një kërkesë kushtetuese është e lejueshme për shqyrtim dhe vendosje. Rregullat që normojnë prezumimet për lejueshmërinë e një kërkese kushtetuese kanë natyrë procedurale kurse ato që kanë të bëjnë me **themeltësinë e kërkesës** i takojnë anës materialo-juridike.

Kushtet për lejueshmërinë e kërkesës kushtetuese, **grosso modo**, mund të ndahen në katër grupe: në grupin e parë hynë kushtet që kanë të bëjnë me **objektin e çështjes** (vlerësimi i kushtetutshmërisë mund të ketë për objekt vetëm aktin juridik, veprimin ose mosveprimin të autoriteteve publike, jo të personave privat; përjashtohet vlerësimi i ligjshmërisë); në grupin e dytë hyjnë kushtet që kanë të bëjnë **me palët** (legjitimi aktiv dhe pasiv i palës, cilësia e të qenit viktimë etj.); në të tretin hyjnë kushtet që kanë të bëjnë me vetë **Gjykatën Kushtetuese** (kuorumi, përbërja e rregullt e saj etj.); dhe, në grupin e katërt dhe të fundit hyjnë kushtet që kanë të bëjnë me vetë përmbajtjen e **kërkesës kushtetuese** (nëse kërkesa ka ngritur çështje kushtetuese, nëse është argumentuar në mënyrë të mjaftueshme etj.) Këto ndryshe quhen edhe **prezumime për lejueshmërinë e kërkesës**, pa plotësimin e të cilave Gjykata nuk mund të lëshohet në vlerësimin e **themeltësisë së kërkesës.**[124]

Kjo renditje e kushteve të lejueshmërisë si më sipër nuk derivohet nga Kushtetuta, Ligji nr. 03/L-121 dhe RP por është produkt i shkencës juridike. Sipas fuqisë së tyre juridike, ndërkaq, prezumimet do të mund të ndaheshin mbi bazën e hierarkisë së burimeve juridike në të cilat gjenden prezumimet si më sipër. Kështu, ta zëmë, prezumimi i shterjes së mjeteve juridike ka përparësi (fuqi sipërore juridike) kundrejt çdo prezumimi tjetër që ka të bëjë me ankesat kushtetuese. Në të gjitha rastet që kanë të bëjnë me anekset kushtetuese, Gjykata Kushtetuese duhet të ndjek **stare decisis** të **GJEDNJ** lidhur me **lejueshmërinë e kërkesës,** duke analizuar dhe vënë në jetë standardet e saj mbi lejueshmërinë e një kërkese të përmbajtur në një aneks kushtetues. Kjo ka ndodhur që nga dita e parë e themelimit të Gjykatës. Ky zbatim, megjithatë, ka efekt të kufizuar dhe afatshkurtër.

Efekti **stare decisis** lindë dhe ka vlerë afatgjate vetëm në vendimet që kanë natyrë meritore. Në rastin e vlerësimit të lejueshmërisë së kërkesës kushtetuese, vendimi nuk është përfundimtar. Kjo nënkupton se relevanca e efektit të **stare decisis** me origjinë në **GJEDNJ** ka efekt relativ dhe të përkohshëm, në mënyrë të njëjtë me efektin që ka **stare decisis** me origjinë nga vetë **Gjykata Kushtetuese**. Shpallja e palejueshme për shqyrtim dhe vendosje meritore e një kërkese bëhet me aktvendim, i cili për shkak të natyrës së vet nuk mund prodhoj **efekt të përgjithshëm juridik**, por vetëm efekt lokal dhe të kufizuar në vetë masën e përkohshme dhe implementimin e saj. Ky efekt lokal apo i kufizuar shtrihet si për sa i përket të gjitha kategorive të prezumimeve procedurale: objektit të çështjes (ta zëmë, objekti i çështjes ka të bëj me vlerësim të ligjshmërisë, jo me një çështje kushtetuese), palëve (ta zëmë, pala nuk është viktimë, apo nuk ka cilësinë e palës së privilegjuar në kuptim të nenit 113.2 të Kushtetutës etj.), Gjykatës (ta zëmë, kuorumi, përbërja e rregullt e saj etj.) dhe vetë kërkesës apo **petitumit** (faktet dhe argumentet e prezantuara nga pala nuk çojnë në konstatimin se kërkesa është qartazi e themeltë).

Ndryshimi i standardit në rastet e shpalljes së një kërkese të palejueshme nuk përbën ndonjë problem të madh. Kjo, megjithatë, nuk do të thotë se aktvendimi për palejueshmëri duhet të jetë arbitrar: i njëjtë i duhet të arsyetohet mirë, në veçanti kur bëhet fjalë për vlerësimin e kushteve të lejueshmërisë që lidhen me **petitumin**. Në këto raste, Gjykata Kushtetuese thuajse futet në vlerësim të meritave të rastit, për të konstatuar se rasti është qartazi i pabazuar. Vija që ndan vendimin për palejushmëri për shkak se kërkesa (petitumi) është qartazi e pabazuar nga vendimi për meritat e rastit është shumë e hollë: çdoherë duhet pasur parasysh që në të ardhmen i njëjti precedent i përdorur për refuzim mund të shndërrohet në precedent për pranim të kërkesës. Në fakt, në vendimmarrjet lidhur me vlerësimin e lejueshmërisë së rasteve, Gjykata çdoherë ka një diskrecion të konsiderueshëm që i lejon asaj injorimin e precedentëve të

[124] Në sferën e vlerësimit të lejueshmërisë së kërkesës, stare decisis i **GJEDNJ** mund të ndiqet vetëm sa i përket kërkesave individuale, por jo edhe kur bëhet fjalë për lejueshmërinë e kërkesave tjera me përjashtim të atyre nga neni 113.7 ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] i Kushtetutës. Se cilat janë prezumimet e lejueshmërisë së kërkesës në rastet e anekseve individuale dhe standardet e **GJEDNJ** lidhur me këtë i kemi sqaruar në seksionin e parë të kapitullit të njëmbëdhjetë (**11.1. Cilësitë themelore të fizionomisë së Gjykatës Kushtetuese dhe specifikat e saj)** të këtij libri.

mëparshme. Pikërisht për këtë arsye vendimi për lejueshmërinë duhet të ketë arsyetim të mirë, të rrjedhshëm, konsistent dhe bindës. Mosarsyetimi si duhet i lejueshmërisë e bënë Gjykatën jokredibile kurse vendimet e saj joserioze dhe të pazbatueshme në praktikë.

13.3.3. Caqet e *stare decisis* në meritat e rastit

Efektet e **stare decisis** më së miri realizohen dhe kuptohen në rastet e vendimmarrjeve meritore. Këtu e kemi fjalën për **efektet horizontale**[125] dhe për **efektet vertikale**[126] të **stare decisis**, pa marrë parasysh nëse është fjala për precedentet e prodhuar nga Gjykata Kushtetuese apo për ato që kanë origjinë nga Strasburgu. Sa i përket materies në të cilën stare decisis gjen zbatim, ajo ka të bëj me liritë dhe të drejtat e njeriut dhe më aspektet tjera të juridiksionit kushtetues që nuk përfshinë liritë dhe të drejtat e njeriut (kontrolli abstrakt i normës, kontrolli kushtetues i gjendjeve të jashtëzakonshme, i referendumeve, konflikti për kompetencë, qeverisja lokale, kushtetutshmëria e partive politike dhe kështu me radhë). Kjo ndarje e efektit stare decisis sipas materies ka rëndësi të dihet sepse dallojnë parametrat matës kur bëhet fjalë për kategorinë e lirive dhe të drejtave të njeriut nga kategoritë tjera të juridiksionit kushtetues që nuk janë liri dhe të drejta të njeriut. Kjo është kështu si në Kosovë ashtu edhe në vendet tjera. U mor vesh gjithnjë e kemi fjalën për vendet e modelit **evropian/kelsenian** të gjyqësisë kushtetuese.

Në vijim si më sipër, sa i përket meritave të rastit, **stare decisis** rregullohet me Kushtetutë, e cila në të njëjtën kohë shërben si parametër kryesor matës, përkatësisht si e drejtë materiale për gjykimin e çështjes. Me përjashtim të saj, ekzistojnë edhe parametra të tjerë matës. Ata mund të kenë formën e ligje të caktuara që mund të shërbejnë si parametër për gjykimin e meritave të rastit. Në përdorimin e tyre zakonisht vjen si shkak i dërgimit që e bën vetë teksti kushtetues, germa apo fryma e tij. Këtë e kemi parë me rastin e ligjeve zgjedhore në Kosovë, të cilat shpiejnë në të drejtën kushtetuese materiale si bazë për vendosje të meritave të rastit, dhe që nuk figurojnë në tekstin kushtetues. Kjo është kështu edhe në vendet tjera që kanë model **evropian/kelsenian** të gjyqësisë kushtetuese. Në **Francë**, ta zëmë, si parametër për kontroll të kushtetutshmërisë shërbejnë tekstet e njohura si **bloc de constitutionalite.** Në këto vende, për dallim nga vendet e sistemit të së drejtës së përgjithshme, vendimet paraprake të gjykatave kushtetuese, apo të gjykatave të tjera ekuivalente me to, duhet të ndiqen gjithnjë në kuadër të interpretimeve të kushtetutës apo parametrave të tjerë që janë përdorur më herët si matës të kushtetutshmërisë, asnjëherë jashtë tyre. Kjo do të thotë se çdo ndryshim i precedentit duhet të mbështetet në parametrat shprehimor të përcaktuar me kushtetutë, me një arsyetim të gjatë dhe të shtjelluar mirë lidhur me shkaqet e ndryshimit të tij. Një gjë e tillë, po ashtu, nënkupton se teksti kushtetues dhe parametrat e tij shërbejnë gjithnjë si parametër matës.[127] U muar vesh, këtu hyjnë edhe parametrat tjerë matës në të cilët dërgon teksti kushtetues.[128] Çdo ndryshim i precedentit duhet në mënyrë të qartë të tregoj caqet e ndryshimit të tij kundrejt normës ekzistues kushtetues dhe dispozitave të saj, jo kundrejt precedentit që ndryshohet. Kjo për shkak se gjykatat kushtetuese mund të ndryshojnë, në parim, vetëm precedentin e tyre, jo normën dhe dispozitat kushtetues që janë miratuar nga organi përfaqësues.

---

[125] Me efekt horizontal të **stare decisis** nënkuptohet respektimi i precedentit të mëhershëm nga gjykata e njëjtë që e ka lëshuar (prodhuar) atë.

[126] Me efekt vertikal të **stare decisis** nënkuptohet respektimi i precedentit nga gjykatat më të ulëta, përkatësisht respektimi precedenteve të gjykatave të shkallës sipërore nga gjykatat e shkallëve më të ulëta.

[127] Me këtë nënkuptohet se, çdo vendim që interpreton apo mëton të sqarojë tekstin ekzistues kushtetues, duhet t'i rrijë sa më shumë besnik atij teksti, duke e ruajtur bërthamën e tij fillestare. Në rastet e vendimeve të gjykatave kushtetuese që kanë të bëjnë me kontrollin abstrakt, organizimin dhe funksionimin e pushtetit, konflikteve për kompetencë etj., çdoherë duhet të kihet parasysh edhe përvoja e vendeve të tjera. Kjo vlen në veçanti për vendet në tranzicion dhe vendet që kanë kaluar nëpër diktatura dhe kanë pasur të kaluar të dhunshme, pa asnjë përvojë në demokracinë kushtetuese.

[128] Në rastin francez, ta zëmë, praktika kushtetuese shpie në Preambulën e Kushtetutës së vitit 1946, Deklaratën mbi të Drejtat e Njeriut dhe të qytetarit (1789) si parametra matës. Kjo njihet, siç u tha, si **bloc de constituionalite**. Kjo, në rastin e Kosovës, është pak më ndryshe sepse dërgimi në tekste të tjera në sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut nuk është bërë si rezultat i praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, por si rezultat i stipulimit shprehimor kushtetues. Në këtë kuptim, si parametra matës shërbejnë secili prej instrumenteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtar nga neni 22 i Kushtetutës. Ka edhe dërgime (referime) të tjera në të cilat na dërgon teksti i Kushtetutës. Në të gjitha këto raste, pra, vendimmarrësi duhet t'i zotërojë mirë instrumentet, marrëveshjet, dokumentet dhe praktikat në të cilat referon teksti primar kushtetues, dhe të dijë t'i vë në jetë siç duhet.

Në kohët e fundit, sistemet e të drejtës civile kanë pësuar një hibridizim si pasojë e ndikimit të standardeve ndërkombëtare mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, në veçanti kur bëhet fjalë për ndikimin e **KEDNJ** në vendet anëtare të **Këshillit të Evropës.** Në këto vende, sikundër kemi sqaruar më herët, **stare decisis** më origjinë nga **GJEDNJ** ka një ndikim të madh në gjyqësinë e tyre kushtetuese. Ai ndikim, megjithatë, dallon në vartësi të saj nëse bëhet fjalë për vendime që kanë të bëjnë me shtetet përgjegjëse në të cilat precedenti i **Strasburgut** duhet të vihet në jetë apo për vendime të dhëna nga lidhur me vendet e treta që janë palë të **KEDNJ.** Në rastin e parë vjen në shprehje efekti inter partes i vendimeve, që nënkupton se shteti kundër të cilit ka vendosur **GJEDNJ** duhet të vejë në jetë verdiktin e saj. Në rast të obstruksionit në zbatim të vendimit të Strasburgut, shteti përgjegjës konsiderohet si shkelës i detyrimeve të tij nga Konventa. Në rastin e dytë, ndërkaq, **stare decisis** merr kuptimin e plotë: shtetet anëtare të **KEDNJ** detyrohen t'u përmbahen dhe t'i respektojnë standardet mbi liritë dhe të drejtat e njeriut ashtu siç janë vendosur ato në interpretimet e **Gjykatës në Strasburg**.

Kjo si më sipër, megjithatë, nuk është e tëra sa i përket efektit të **stare decisis** në meritat e rastit në rastin e Kosovës. E drejta e precedentit kushtetues, e shtretëzuar **per constitutionem** në dispozitën e nenit 53 të Kushtetutës, shtrihet edhe ndaj vendimeve meritore që kanë natyrë tjetër dhe që nuk bien në asnjërin prej rasteve si më sipër. Sipas urdhrit të nenit 53 të Kushtetutës, vendimet meritore në sferën e lirive dhe të drejtave individuale përbëjnë stare decisis, pa asnjë kushtëzim, si për sa i përket anës faktike ashtu edhe asaj juridike. Një urdhër si ky, e thënë me fjalë të tjera, detyron Gjykatën Kushtetuese për të marr si premisë të sipërme (premisa major) çdo aspekt të anës faktike dhe juridike të vendimeve të Gjykatës së Strasburgut me rastin e vendosjes për liritë dhe të drejtat individuale. U mor vesh, ky zbatim pa kusht i precedenteve të Strasburgut për aq sa ato kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat e njeriut nënkupton që Gjykata Kushtetuese (dhe autoritete tjera publike) nuk guxojnë të zëvendësohen në vend të saj dhe të luan rolin e një gjykate ndërkombëtare. Krejt çfarë do të thotë urdhri nga neni 53 i Kushtetutës është se **stare decisis** me origjinë nga Strasburgu duhet të vihet në jetë në Kosovë në formë të respektimit të standardeve të vëna atje. Kjo është kështu për shkak se zbatimi i vendimeve të GJEDNJ nuk përbën një detyrim për Kosovën ngaqë nuk është anëtare e Konventës dhe shtet anëtar në Këshillin e Evropës. Ajo që Kosova duhet të bëjë, është që stare decisis të vihet në jetë në kuptim të implementimit të standardeve mbi liritë dhe të drejtat e njeriut që vihen në Strasburg dhe, anasjelltas, çdoherë kur këto standarde ndryshohen në origjinën e tyre, e njëjta të vlejnë edhe për Kosovën dhe Gjykatën Kushtetuese.

E thënë edhe më saktësisht, kjo si më sipër do të thotë se në Kosovë me precedent të **GJEDNJ** nënkuptohen të gjitha vendimet e saj, të cilat mund të gjejnë shprehje në vendimmarrjen e **Gjykatës Kushtetuese**, si për sa i përket anës faktike ashtu edhe anës së tyre juridike. Në rastin tonë, thënë me fjalë të tjera, dallimi në mes të vendimeve që kanë të bëjnë me vendin përgjegjës dhe atyre që janë palë në Konventë nuk ekziston. **Kosova** ka miratuar njëanshëm **KEDNJ**, duke e bërë pjesë të normave të saja kushtetuese, dhe ka marrë përsipër detyrimin që të marrë si **stare decisis** çdo interpretim që vjen nga Strasburgu dhe që ka të bëj me liritë dhe të drejtat e njeriut të garantuara me Konventë.

Në vendimmarrjen e **Gjykatës Kushtetuese**, e drejta e precedentëve me origjinë nga **Strasburgu** përfshinë si parametër jo vetëm të drejtën materiale që mishërohet në **KEDNJ** ashtu siç është interpretuar nga **GJEDNJ**, por edhe çdo të drejtë tjetër, qoftë ajo e **drejtë butë** (mendimet e **Komisionit të Venecias**, qëndrimet e dijetarëve të ndryshëm apo organizatave tjera joqeveritare dhe kështu me radhë) apo e **drejtë e fortë** (dispozitat juridike me fuqi juridike të **BE-së** etj.), të cilën e ka vënë në përdorim **GJEDNJ** me rastin e vendosjes. Në të njëjtën kohë, kjo nënkupton se **Gjykata Kushtetuese** mund të ndryshojë të drejtën e vet të precedentëve vetëm për ato raste që nuk kanë të bëjnë me të drejtën materiale të krijuar nga **GJEDNJ** gjatë interpretimit nga ana e saj të **KEDNJ.** Për këto raste, përjashtimisht, **Gjykata Kushtetuese** çdoherë është e lidhur me të drejtën materiale të mishëruar në **KEDNJ** ashtu siç interpretohet nga **Strasburgu**. Në këtë kuptim, precedenti i **Strasburgut** shërben si një busull për t'u orientuar Gjykatën Kushtetuese gjatë interpretimit të dispozitave materiale kushtetuese dhe dispozitave të tjera që shërbejnë si parametër për vlerësimin e kushtetutshmërisë me qëllim të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave individuale të garantuara me Kushtetutë.

13.4. Komente dhe pyetje

13.4.1. Precedentët, të njohur ndryshe si **stare decisis**, janë zënë në gojë në veprat letrare të klasikëve të letërsisë. U mor vesh, në një kuptim pezhorativ, për t'i paraqitur si praktika të shëmtuara të juristëve që kanë për qëllim ruajtjen e statusin të privilegjuar të juristëve në shoqëri. Në lëmin e drejtësisë, ndërkaq, **stare decisis** ka shërbyer dhe shërben si një instrument i mirë dhe efektiv për vendosjen e rasteve praktike. Ajo që ndiqet nga gjyqtari i mëvonshëm njihet si **ratio decidenti**. Nga gjyqtari i mëvonshëm, i cili mbështetet në precedent me rastin e vendosjes, pra, merren parasysh jo pjesët tjera të vendimit por vetëm arsyet që kanë udhëhequr gjyqtarin e mëparshëm për të vendosur një rast apo mosmarrëveshje. Dilema që shtrohet këtu është se çka janë **ratio decidenti**, cilat pjesë të vendimit, të cilat gjyqtari i mëvonshëm i merr parasysh më vonë kur vendos një rast apo mosmarrëveshje kushtetuese? A janë ato aspektet e faktit, rrethanat jetësore ashtu siç kanë ndodhur në të kaluarën që duhet të riinterpretohen në ndritën e një rasti të ri që duhet të zgjidhet, aspektet juridike, përkatësisht baza juridike mbi të cilën është mbështetur vendimi i mëhershëm, apo dyja së bashku? Diskutoni!

13.4.2. Në gjyqësinë kushtetuese, **precedentet e zgjidhjes** (**precedents of solution**) dhe **precedentet e interpretimit** (**precedents of interpretation**) gjejnë shprehje të plotë vetëm në rastet e vendimmarrjes meritore. Tregoni se çfarë nënkupton njëri dhe çfarë tjetri precedent dhe pse kjo është kështu te vendimmarrja meritore? Si është gjendja me vendimmarrjen jomeritore? Shtjelloni këtë dallim në të këtyre dy precedentëve në dy llojet e vendimmarrjeve si më sipër duke pasur parasysh në veçanti rastin e a.q. të bartjes së shamive nëpër shkollat kosovare! A hyn kjo qasje në **stare decisis** që duhet të ndiqet nga tjerët në të ardhmen dhe, për më tepër, a paraqet aktivizim gjyqësor? Pse jo?

13.4.3. Ndër funksionet më pak të dukshme të **stare decisis** hyjnë, ta zëmë, sigurimi i një gjykimi të drejtë dhe të paanshëm, ngritja e besimit në drejtësi, **e*fiçenca*** dhe konsistenca në ushtrimin e drejtësisë, parashikueshmëria dhe ekonomizimi në administrimin e drejtësisë etj. Mirëpo, ekzistojnë dy funksione tjera primare që ka luajtur dhe luan stare decisis që nga lindja e tij si një instrument juridik. Cilat janë ato dy funksione primare? Përshkruani!

13.4.4. Në **Romë** kanë ekzistuar disa forma të aktivitetit juridik të zyrtarëve romak, përfshirë perandorin si zyrtarin më i lartë. Ato forma janë quajtur **edikte**, të cilat, megjithatë, nuk kanë pasur statusin e **stare decisis**. Pse? Kush ka pasur një status të **stare decisis** që pak ngjason me kuptimin modern të këtij termi? A janë precedentet apo shkenca juridike që kanë gëzuar një status që sot ngjason me **stare decisis** dhe cilat shkaqe kanë kushtëzuar një status të tillë?

13.4.5. Në **Angli** u zhvillua një kulturë tjetër juridike, krahasuar me sistemin civil të së drejtës, sa i përket rolit dhe pozitës së precedenteve gjyqësore në sistemin juridik dhe kushtetues të këtij vendi. Diskutoni!

13.4.6. Lindja e pozitivizmit ka pasur pasoja në sferën e precedentit. Diskutoni!

13.4.7. Lindja e pozitivizmit në **Evropë** në shek. XVIII ka pasur për rrjedhojë rrënimin dhe braktisjen graduale të kulturës së precedentit. U mor vesh, këtu e kemi fjalën për sistemin civil të së drejtës. Kjo gjendje u krijua për dy arsye. Cilat janë dy arsyet të cilat bën që kultura e precedentit në **Evropë** të mos jetë më pjesë e jetës dhe punës së gjyqtarëve kontinentalë?

13.4.8. Në vendet ish-komuniste, ku bën pjesë edhe Kosova, stare decisis as që njihej: as teoria e as praktika nuk i jepnin ndonjë rëndësi këtij koncepti. Kjo situatë ka nisur me fitoren e komunizmit në **Rusi** dhe krijimin e ish-**BRSS**. Më vonë u përhap gjithandej në katër anët e botës. Cila ka qenë arsye kryesore që ka çuar në mohimin e tërësishëm teorik dhe praktik të vendeve ish-komuniste të doktrinës **stare decisis**? A ka ndonjë lidhje ky mohim me krijimin e gjykatave kushtetuese në vendet ish-komuniste, si institucione të ndara nga gjyqësori i rregullt?

13.4.9. Në gjyqësorin e rregullt në **sistemin civil**, stare decisis ka një ndikim de facto, jo si një burim formal i së drejtës. Kjo do të thotë se ky koncept gjen shprehje vetëm si një inspirim me forcë argumentuese

juridike për gjyqtarin që vendos një rast. Kjo gjendje ndryshon kur bëhet fjalë për gjyqësinë kushtetuese, ku **stare decisis** nuk dallon shumë nga sistemi i të **drejtës së përgjithshme**. Çfarë do të thotë kjo? Diskutoni!

13.4.10. Në vendet që kultivojnë **modelin kelsenian/evropian** të gjyqësisë kushtetuese, e drejta e precedentëve realizohet përmes efektit të përgjithshëm apo **erga omnes** të vendimeve gjyqësore. Kjo, megjithatë, nuk përfshin të gjitha sferat e vendimmarrjes, por vetëm sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të kontrollit abstrakt të kushtetutshmërinë. Këtë realizim të **stare decisis** përmes efekteve të përgjithshme të vendimeve të gjykatave kushtetuese në këto vende e garantojnë kushtetutat nacionale. Çfarë do të thotë kjo dhe cili është dallimi në mes të **stare decisis** dhe efektit të përgjithshëm të vendimeve gjyqësore?

13.4.11. Në rendin kushtetues kosovar kapitujt mbi liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve gjenden në kapitujt dy dhe tre të Kushtetutës së vitit 2008. Ky status i privilegjuar sot përbën një standard që sanksionohet në të gjitha vendet demokratike të botës liberale, së cilës i takon **Kosova**. Në kuadër të këtij statusi të privilegjuar, një status të caktuar zënë instrumentet dhe dokumentet kryesore ndërkombëtare e regjionale. Cili nen i Kushtetutës i njeh një status të privilegjuar instrumenteve e dokumenteve si më sipër?

13.4.12. Në Kosovë, **KEDNJ** ka një status të privilegjuar, si pjesë përbërëse e këtij statusi që gëzojnë shumë instrumente e dokumente ndërkombëtare. Ky status i privilegjuar i njeh këtij dokumenti statusin kushtetues. Në këtë drejtim, **Kosova** nuk është vetëm. Dallimi në mes të Kosovës dhe vendeve tjera që po ashtu i njohin statusin kushtetues **KEDNJ** konsiston në teknikën juridike të inkorporimit të saj në të drejtën e brendshme. Për çfarë bëhet fjalë? Cilat janë tri praktika evropiane lidhur me statusin juridik të **KEDNJ** në të drejtën e brendshme? Cili është dallimi në mes të statusit kushtetues të **KEDNJ** dhe statusit super-legjislativ që këtij dokumenti i akordohet në disa vende evropiane?

13.4.13. Instrumentet dhe marrëveshjet kryesore që listohen në nenin 22 të Kushtetutës dhe që kanë status të një norme kushtetuese, e barabartë me çdo normë tjetër kushtetuese, shpesh nuk kanë natyrën e **normave të vetekzekutueshme**. Kjo nënkupton se këto instrumente dhe këto marrëveshje ndërkombëtare kanë nevojë për legjislacion impelementues shtesë për t'i vënë në jetë në sistemin e brendshëm juridik. Çka nënkuptohet me legjislacion implementues dhe çfarë forme ka ai?

13.4.14. Ekzistojnë disa dispozita kushtetuese kosovare, të cilat, në esencë, për nga fuqia e tyre juridike qëndrojnë mbi **Kushtetutën e Kosovës**. Kjo nënkupton se këtu nuk flitet për norma që kanë statusin e normave të rangut kushtetues, **super-legjislativ** apo të ngjashme. Më shumë se kaq, këtu flitet për norma që kanë status **super-kushtetues** dhe rrinë (qëndrojnë) mbi secilën normë kushtetuese për sa i përket materies që rregullojnë (normojnë). Për çfarë bëhet fjalë këtu? Diskutoni!

13.4.15. Në Kosovë ekziston një detyrim kushtetues nga neni 53 i Kushtetutës, sipas së cilit të gjitha autoritetet kosovare duhet të interpretojnë dispozitat kushtetuese lidhur me liritë dhe të drejtat e njeriut në frymën e praktikës gjyqësore të **GJEDNJ**. A përfshinë ky detyrim kushtetues vënien në jetë të vendimeve individuale meritore të **GJEDNJ,** të kuptuara si vendime **res judicata**, apo vetëm detyrimin për të vënë në jetë mënyrën se si **GJEDNJ** ka interpretuar **KEDNJ** (**res interpretata**)"?

13.4.16. Praktika gjyqësore e **GJEDNJ** lidhur me interpretimin e **KEDNJ** nuk është autoreferenciale. Çfarë do të thotë kjo? Diskutoni!

13.4.17. Krahas **stare decisis** të **Gjykatës së Strasburgut** ekzistojnë edhe burimet tjera të huaja, përfshirë këtu burimet e natyrës së të **drejtës së butë**, të cilat kanë gjetur dhe gjejnë vend të spikatur në **ratio decidenti** të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Për më tepër, ka raste kur një **burim i butë** përmes miratimit të tij nga **Kuvendi i Kosovës** është kthyer në të drejtë të fortë, përkatësisht në një burim formal të së drejtës me rëndësi parësore. Për çfarë bëhet fjalë këtu? Diskutoni!

13.4.18. Ndër burimet e së drejtës që listohen në praktikën gjyqësore të gjykatave të huaja kushtetuese hyn edhe shkenca juridike. Lidhur me këtë, në literaturë është vërejtur se vendet e ndryshme dallojnë ndërmjet veti sa i përket raportit të gjyqtarëve kushtetues me literaturën juridike dhe përdorimin e saj në arsyetimin argumentativ të verdiktit. Dallimi nuk mbaron me kaq: ai shpërfaqet edhe në metodat, konceptet dhe doktrinat që janë me origjinë nga shkencat juridike dhe që përdoren nga gjyqtarët kushtetues me rastin e vendimmarrjes së tyre. Në këtë kontekst dallohen disa lloje të praktika nacionale. Diskutoni!

13.4.19. Në vendimmarrjen e saj, **Gjykata Kushtetuese e Kosovës** përdor kategoritë tjera si burime të së drejtës, krahas Kushtetutës, duke përjashtuar përdorimin e literaturës shkencore juridike si burim të së drejtës. Deri më sot, me dy përjashtime, kjo gjykatë me zell të madh ka përdorur kategoritë tjera të së drejtës së huaj në mbështetje të vendimmarrjes së saj. Për cilat kategori të së drejtës së huaj bëhet fjalë këtu? Diskutoni!

13.4.20. Aktualisht ekzistojnë tri lloje të burimeve të së drejtës së huaj, të cilat i ka vënë në punë **Gjykata Kushtetuese e Kosovës**: në grupin e parë hyn praktika e gjykatave të huaja kushtetuese, si dhe zgjidhjet e huaja kushtetuese e ligjore (në disa raste, dy këto burime përdoren në të njëjtën kohë në pjesën arsyetuese me qëllim të argumentimit të verdiktit përfundimtar të Gjykatës); në grupin e dytë hyjnë mendimet dhe vendimet e **Komisionit të Venecias** dhe të mekanizmit të tij të brendshëm, **Forumit të Venecias** (më shpesh përdoren si argument qëndrimet e këtij të fundit sepse reflekton përvojën nacionale të vendeve anëtare të Komisionit); dhe, në fund, në grupin e tretë të burimeve të së drejtës hyjnë praktika e **GJED** dhe **GJND**. Me përjashtime të vogla, në tri llojet e cekura më sipër, çdoherë bëhet fjalë për vendimmarrje meritore, përkatësisht për aktgjykime të **Gjykatës Kushtetuese** në të cilat ekziston argumentimi duke u mbështetur në burime të huaja juridike. Diskutoni për tri grupet si më sipër nga një vendim meritor të Gjykatës Kushtetuese dhe tregoni se për çfarë natyre të burimit të së drejtës bëhet fjalë.

13.4.21. Statusi kushtetues i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në nivel **vertikal** konsiston në gëzimin nga ana e tyre të një epërsi absolute kundrejt vendimeve të gjyqësorit të rregullt dhe vendimeve të autoriteteve tjera publike në vend. Të gjitha autoritetet gjyqësore në Kosovë, si dhe të gjithë subjektet e së drejtës, me rastin e vendosjes janë të detyruar që të shërbehen me atë **ratio decidendi** që gjendet brenda vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, pa asnjë mundësi kualifikimi apo riinterpretimi. Ky kuptim i **stare decisis** është më i ngushtë se efekti juridik i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Çfarë don të thotë kjo? Diskutoni!

13.4.22. Ekzistojnë dy metoda të miratimit (pranimit) të precedentit në praktikën e **Gjykatës Kushtetuese.** Në rastin e metodës së parë, fjala është për pranimin si parametër për vendosje të një situate reale faktike nga e kaluara, përkatësisht të procesit të formimit (lindjes) së rastit në nivel nacional si dhe të vetë mënyrës se si është interpretuar (zgjidhur) kjo situatë faktike nga **Gjykata e Strasburgut.** Në rastin e metodës së dytë, ndërkaq, si detyrim me natyrë precedenti paraqitet vetëm teksti i prodhuar jashtë vendit (teksti i huaj nacional), i marrë si i shkëputur nga çdo ngjarje reale faktike. Në rastin e metodës së fundit, pranimi (miratimi) si parametër për vendosje i tekstit të huaj nga gjykata nacionale, pa marrë parasysh gjendjen reale faktike të lindjes së rastit, shoqërohet me një analizë të caktuar të tij me qëllim të përshtatjes rrethanave të rastit konkret nacional që pret zgjidhje. Këtu teksti i analizuar shërben në të njëjtën kohë si bazë e juridiko-kushtetuese e vendimmarrjes. Arsyetimi i vendimmarrjes gjyqësore në rastin e parë është i lidhur për analizën e gjendjes reale jetësore, kurse në të dytin ndiqet logjika e arsyetimeve që një ligjvënës i huaj e jep me rastin e draftimit të ligjeve. Për cilat raste nga neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara} i Kushtetutës gjen zbatim metoda e parë e për cilat raste metoda e dytë apo tekstuale.

13.4.23. Në kuadër të kërkesave që përmban një vendim për vënien e masës së përkohshme mund të jenë kërkesa për pezullim të ekzekutimit të një ligji, të një vendimi gjyqësor, të ndonjë veprimi tjetër të organit përkatës publik kosovar etj. Emërues i përbashkët i tyre është urdhri drejtuar autoriteteve

publike për pezullimin apo ndalimin e një veprimi të caktuar. Thënë me fjalë tjera, kur **Gjykata Kushtetuese** miraton kërkesën për vënien e masës së përkohshme, atëherë vjen deri te pezullimi apo ndalimi për një periudhë të caktuar me vendim i ndërmarrjes nga ana e autoritetit përkatës publik të një veprimi të caktuar. Një gjë e tillë përbën esencën e **efektit të përgjithshëm** të vendimeve të Gjykatës, i cili dallon nga **stare decisis**. Diskutoni!

13.4.24. Në jurisprudencën e **GJEDNJ** dy kushte janë që duhet të plotësohen për vënien e masave të përkohshme ndaj një shteti: e para, faktet duhet të flasin **prima facie** për cenim të dispozitave të **KEDNJ**; dhe, e dyta, dështimi (ometimi) për vënien e masave të përkohshme të mbrojtjes duhet të rezultojë apo kërcënon të rezultojë në shkaktimin e dëmit të pariparueshëm të interesave të caktuara vitale të palëve ose të vetë procesit të shqyrtimit gjyqësor të rastit. E drejta kosovare definon, përmes një formulimi të ndryshëm, por me efekt shumë të ngjashëm, cilësitë potenciale të pasojave të dëmshme që vendimi për vënien e masës së përkohshme të mbrojtjes synon t'i parandaloj në mënyrë që të mos ndodhin. E kemi fjalën këtu për Kushtetutën, **Ligjin nr. 03/L-121** dhe **RP**, dispozitat e të cilave trajtohen në vijim. Diskutoni!

13.4.25. Në vendimin për vënien e masës së përkohshme nuk mund të ketë **mendim mospajtues** apo **konkurrues**, nisur nga fakti se objekt i vendimit për vënien e masës së përkohshme të mbrojtjes nuk është çështja meritore, por një akt juridik apo një situatë jetësore që potencialisht mund të prodhojë rrezik për shkaktim të dëmeve të pariparueshme ndaj individit apo rrezik dëmtim të interesit publik. Në praktikën e **Gjykatës Kushtetuese**, megjithatë, ka pasur rast kur gjyqtarët kanë dhënë mendim mospajtues ndaj vendimit për vënien e masës së përkohshme: në rastin e njohur si rasti i **RTK-së**, gjyqtarët **Almiro Rodrigues** dhe **Gjyljeta Mushkoilaj** patën paraqitur mendimet e tyre mospajtuese. Rasti i **RTK**-së ka qenë rasti i parë në historinë e Gjykatës Kushtetuese, i cili në kabllogramet e **WikiLeaks** u pat cilësuar si versioni kosovar i **Marbury vs. Madison.** Diskutoni përmbajtjen e mendimeve mospajtuese të këtyre dy ish-gjyqtarëve të **Gjykatës Kushtetuese.**

13.4.26. Koncepti i masave të përkohshme në kuadër të sistemit të Gjykatës së Strasburgut nuk ka lindur nga një aktivitet normative i vendeve anëtare të **KEDNJ.** Ato lindën si rezultat i praktikës gjyqësore Gjykatës së Strasburgut. Kur u bë sanksionimi i tyre juridik, kur kjo ndodhi, u bë përmes një aktiviteti normative më të ultë se **KEDNJ**. A do të thotë kjo se vënia e masave të përkohshme nuk paraqet një detyrim për t'u zbatuar nga shtetet anëtare të **KEDNJ**? A nënkupton kjo që mosrespektimi i tyre nuk përbën cenim të **KEDNJ** ? Përgjigjet në këto dy pyetje duhet të kenë formën e diskutimit të detajuar lidhur me origjinë, kuptimin dhe natyrën juridike të masave të përkohshme në kuadër të sistemit të **Gjykatës së Strasburgut.**

13.4.27. Caqet e vendimit për vendosjen e masave të përkohshme dallojnë kur bëhet fjalë për vlerësimin e kushteve të lejueshmërisë së kërkesës. Katër janë kushtet për lejueshmërinë e kërkesës, të cilat duhen plotësuar para se Gjykata të lëshohet në vlerësimin e meritave të rastit. Vendimi me të cilin vihen masat e përkohshme vlerëson se janë plotësuar njëri prej këtyre katër llojeve të kushteve për vënien e tyre dhe ka efekt të caktuar. Cilat janë katër kushtet që duhen plotësuar paraprakisht në mënyrë që Gjykata të kalojë në shqyrtimin e themeltësisë së kërkesës dhe vendosjen e saj? Cili është efekti i vendimit për masat e përkohshme dhe çka dallon ky efekt nga efekti që kanë vendimet meritore?

13.4.28. Në vendimmarrjen e **Gjykatës Kushtetuese**, e drejta e precedentëve me origjinë nga **Strasburgu** përfshinë si parametër jo vetëm të drejtën materiale që mishërohet në **KEDNJ** ashtu siç është interpretuar nga **GJEDNJ**, por edhe çdo të drejtë tjetër, qoftë ajo e **drejtë butë** (mendimet e **Komisionit të Venecias**, qëndrimet e dijetarëve të ndryshëm apo organizatave tjera joqeveritare dhe kështu me radhë) apo e **drejtë e fortë** (dispozitat juridike me fuqi juridike të **BE**-së etj.), të cilën e ka vënë në përdorim **GJEDNJ** me rastin e vendosjes. A mund Gjykata Kushtetuese e Kosovës të devijojë nga precedenti me origjinë nga Strasburgu me rastin e vendosjes së një rasti? Diskutoni në veçanti duke shpjeguar se cilat precedente të Gjykatës Kushtetuese mund të ndryshohen!

13.5. Lexim shtesë

- Thomas Healy, "Stare Decisis as a Constitutional Requirement". *West Virginia Law Review* Vol. 104 Issue 1 (2001);
- Karen Reid, *A Practitioner's Guide to the European Convention on Human Rights*. Second Edition (Sweet Maxwell Ltd.: London, 2004);
- Daniel A. Farber, "The Rule of Law and the Law of Precedents" Minnesota Law Review Vol. 90 (2005-2006);
- Thomas Healy, "Stare Decisis and the Constitution: Four Questions and Answers". *Notre Dame Law Review* Vol. 83 Issue 3 (2008);
- Robin C.A. White & Clare Ovey, *The European Convention on Human Rights*. Fifth Edition (Oxford University Press: Oxford, 2010) ;
- Philip Leach, *Taking a Case to the Euroepan Court of Human Rights*. Third Edition (Oxford University Press, Oxford, 2011);
- Jasna Omejec, *Konvencija za zastitu ljudskih prava i temeljnih sloboda u praksi Evropskog suda za ljudska prava: strasbourški acquis* (Novi Inormator: Zagreb, 2013);
- Marc Jacob. *Precedents and Case-based Reasoning in the European Court of Justice* (Cambridge University Press: Cambridge, 2014).

14. AKTIVIZMI GJYQËSOR SI MODUS OPERANDI DHE ÇËSHTJE TË TJERA

Përgjithësisht. - Fenomeni i **aktivizmit gjyqësor** në gjyqësinë kushtetuese është riaktualizuar me një dramacitet të theksuar me valën e fundit post-komuniste të përhapjes së gjykatave kushtetuese të modelit **kelsenian/evropian**, përkatësisht me nisjen e themelimit masiv të gjykatave kushtetuese në vendet ish-komuniste.

Ai ka qenë i njohur dhe ka ekzistuar si një fenomen kontrovers dhe mjaft i diskutueshëm në **SHBA** dhe në vendet tjera të demokracive perëndimore. Formulimin doktrinar të këtij fenomeni e gjejmë qysh në diskutimet mbi të a.q. **realizmi legal** të autorit **Oliver Wendell Holmes Jr**., në kohën sa ka shërbyer si gjyqtar i **Gjykatës Supreme të SHBA** në vitet 1902-1932. Vetë lindja e aktivizmit gjyqësor, ndërkaq, ka zanafillën në rastin **Marbury vs. Madison** (1803), i cili në të vërtetë përbën një aktivizëm gjyqësor në vetvete nisur nga fakti se praktika e kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë, përkatësisht praktika e sigurimit përmes rrugës gjyqësore të supremacisë (epërsisë) së kushtetutës kundrejt normave të tjera juridike ka lindur jashtë përcaktimeve të normave kushtetuese të Kushtetutës së **SHBA**-ve të vitit 1787.[1]

Nga sa më sipër, gabimisht mund të mendohet se aktivizmi gjyqësor ka lindur si rezultat i ideve të autorëve perëndimorë që janë marrë me tema nga e drejta kushtetuese dhe aspektet tjera lidhur me lindjen dhe organizimin shtetëror dhe liritë e të drejtat e individit. Në këtë mes, mendja shkon menjëherë të dijetarët si **John Loku** (John Locke: 1632-11704), **Baroni Monteskije** (Montesquieu:1689-1755), **Aleks de Tokvil** (Alexis de Tocqueville:1805-1859), **Aleksander Hamilton** (Alexander Hamilton:1755 ose 1757-1804) dhe shumë dijetarë tjerë, të cilët, pa asnjë diskutim, kanë ndikuar në aktivizmin gjyqësor në **SHBA** dhe në vendet tjera perëndimore para shekullit 20-të. Të gjithë këta dijetarë kanë avokuar dhe janë angazhuar për një gjyqësi të pavarur, e cila do të moderonte ushtrimin e pushtetit shtetëror në praktikë, të sovranitetin shtetëror të brendshëm, përmes ofrimit të garancioneve të caktuara kushtetuese dhe të mekanizmave balancues të pushtetit. Me këtë, këta autorë, në mënyra të ndryshme i kanë vënë themelet e konstitucionalizmit liberal duke i vënë rregullat e lojës politike në kushtetutë dhe ligje, mirëpo pa i dhënë të drejtë gjyqtarit që të ushtroj ligjvënie. Një gjendje e tillë pak a shumë u shpërfaq edhe në praktikën e vendeve liberale perëndimore në dy anët e Atlantikut: fokusi teorik dhe praktik ngeli të ndarja dhe balancimi i pushteteve si formë e qeverisjes së mirë, pa i njohur gjyqësorit ndonjë të drejtë apo fjalë të fundit lidhur me kushtetutshmërinë e formimit të normës juridike dhe akteve të tjera të përgjithshme.

Kjo qasje teorike dhe praktika e bazuar në te u sfiduan nga ideja e gjyqtarit të sipër cekur amerikan, **Oliver Wendell Holms Jr**., i cili pohoi se nuk ekzistojnë të vërteta natyrore të përjetshme të shkapërderdhura nëpër dispozita kushtetuese dhe ligjore që janë në pritje të gjyqtarëve për t'i zbuluar me rastin e gjykimit. Nuk ka ndonjë dallim të madh në mes të normëkrijimit gjyqësor dhe normëvënies përmes përfaqësuesit të sovranit - parlamentit: kuptimi i kushtetutës dhe i ligjeve përcaktohet sipas raportit momental të forcave gjatë gjykimit konkret në të cilin kryhet interpretimi gjyqësor me qëllim të vënies së tyre në jetë, duke e lënë anash çdo kuptim të tyre origjinal.[2] Nga ky mendim i gjyqtarit në fjalë, del në mënyrë të hapur se ideja themelore prapa lindjes së aktivizmit gjyqësor ka qenë zgjidhja e dilemës në

[1] Cf. më shumë për këtë në monografinë e shkëlqyer lawrence Goldstone, *The Activist: John Marshall, Marbury v Madison, and the Myth of Judicial Review* **(Walker Publishing Company Inc.: New York, 2008).**

[2] Paul O. Carrese, *The Cloaking of Power: Montesquieu, Blackstone, and the Rise of Judicial Activism* (The University of Chicago Press: Chicago, 2003) fq. 6, 231-255.

mes të kuptimit fillestar (**origjinal**) të normës kushtetuese dhe ligjore dhe kuptimit që ato marrin gjatë interpretimit gjyqësor **(kuptimi derivativ**). Si pikë nisëse për këtë botëkuptim gjyqtarit i ka shërbyer **e drejta e përgjithshme** (**common law**): kjo e drejtë, e bazuar në precedentet në **Angli** dhe **SHBA**, paraqet ligj dhe jo prodhimet formale të parlamenteve që bazohen në përgjithësime abstrakte dhe në kritere morale. Thënë me fjalë të tjera, sipas tij, tërësia e precedentëve të prodhuar në **Angli** dhe **SHBA** përgjatë historisë përbëjnë ligjin e vendit. Kjo, e bartur në terrenin kushtetues, nënkuptonte që as **Kushtetuta e SHBA**-ve nuk mund të paraqitej si një normë që mund të zbatohej në mënyrë të drejtpërdrejtë: dispozitat kushtetuese përmbajnë vetëm udhëzime për gjyqtarët se si duhet të zbatojnë në rastet dhe mosmarrëveshjet konkrete precedentet e krijuara më herët nga gjykatat në **Angli** dhe **SHBA,** konsideronte ky autor. Pse në **Angli**? Sepse këtu bëhet fjalë për precedentët anglez që kanë vlejtur në territorin e **SHBA**-ve gjatë kohës së sundimit kolonial. Kjo qartë shihet nga shtjellimet e gjata të autorit në fjalë në librin e tij **The Common Law**, botuar në vitin 1881 (Little, Brown and Company: Boston).

Në këtë periudhë, megjithatë, akoma nuk mund të flitet për lindjen e konceptit të aktivizmit gjyqësor. Krejt çka mund të thuhet lidhur me pikëpamjet e këtij autori konsiston në atë se kjo qasje, e njohur si **realizmi legal**, paraqet pikën nisëse për shkëputjen e kuptimit të ligjit nga forma e tij. Kjo e fundit ka konotacione të shpeshta morale: supozohet që ligji normon çdo rrethanë jetësore ashtu që gjyqtarët vetëm duhet t'i zbulojnë ato me rastin e zbatimit të tij në gjatë zgjidhjes së rasteve dhe mosmarrëveshjeve konkrete.

Sikundër vërehet, vija bazë (nisëse) e debatit që asocon në aktivizëm gjyqësor ka të bëj me normën juridike abstrakte dhe kontrollin e kushtetutshmërisë së saj. Kjo ka qenë kështu përgjatë tërë zhvillimi të gjyqësisë kushtetuese perëndimore deri në ditët e sotme. E thënë me fjalë të tjera, vetë terreni ku ka lindur dhe ku është zhvilluar fenomeni i aktivizmit gjyqësor i referohet kontrolli gjyqësor të kushtetutshmërisë së normave abstrakte të natyrës ligjore. Këtë e provon si lindja e gjyqësisë kushtetuese në rastin **Marbury vs Madison** (1803) ashtu edhe debati në frymën e **realizmit legal**, i nisur nga gjyqtari i sipër cekur amerikan. Më pastaj, me kohë aktivizmi është bartur në terrenin e kontrollit kushtetues të akteve juridike (të përgjithshme dhe individuale), të veprimeve dhe mosveprimeve tjera të autoriteteve shtetërore dhe autoriteteve të tjera publike. Kjo bartje e **aktivizmit gjyqësor** në sferat tjera të juridiksionit të gjyqësisë kushtetuese ka ndodhur në mënyrë të qartë vetëm pas vitit 1945. Sidoqoftë, ajo që duket qartë nga kjo që thamë deri këtu është se mendimet e dijetarëve dhe teoricienëve të së drejtës kushtetuese dhe të shtetit modern nuk kanë pasur ndonjë ndikim të prekshëm në këtë proces të lindjes së aktivizmit gjyqësor. Kanë qenë rrethanat dhe forcat shoqërore specifike, jo aq shumë shtjellimet teorike e doktrinare, ato që kanë kushtëzuar lindjen e gjyqësisë kushtetuese, të kontrollit gjyqësor të aktivitetit shtetëror me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së kushtetutës.

Ato rrethana e forca shoqërore, në kuptimin si më sipër, kryesisht kanë pasur natyrë evolutive. Çështja e aktivizmit gjyqësor çdoherë ka dalë në syprinë pas shfaqjes së këtyre rrethanave e forcave që kanë ndryshuar rrënjësisht formën e qeverisjes dhe natyrën e shtetit modern. Kështu ka ndodhur pas **Luftës së Dytë Botërore**, ku roli transformues i gjykatave të reja kushtetuese në **Austri, Gjermani** dhe **Itali** ka qenë kolosal në transformimin e këtyre shoqërive drejt konstitucionalizmit liberal perëndimor. Njëjtë ka ndodhur edhe me vendet e **Evropës Jugore**, të cilat kishin dalë nga diktaturat brutale e dekadave të tëra (**Greqia, Portugalia** dhe **Spanja**), aty kah mesi i viteve '70 të shekullit të kaluar. Asnjë dallim në këtë drejtim nuk ka koha pas rrënimit të komunizmit, kur përhapja e këtij fenomeni ka qenë masiv dhe gjerësisht i dukshëm, krejt si pasojë e rrethanave e forcave të reja shoqërore që u krijuan në atë kohë. Një gjë e tillë shihet nga numri i shkrimeve të shkruara në fillim të viteve '90 të shekullit të kaluar, mbi tre mijë sosh, të cilat kanë trajtuar këtë fenomen,

fenomenin e përhapjes së gjyqësisë kushtetuese dhe të fenomenit të aktivizmit gjyqësor si një produkt i saj, trend që ka vazhduar edhe në dekadat e para të shekullit të tanishëm.[3]

Fenomeni i aktivizmit gjyqësor, në literaturë zakonisht asocohet me togfjalëshin **ligjvënësi negativ vs ligjvënësi pozitiv**.[4] Më pastaj, nën këtë term janë futur edhe përbërës të tjerë. Në kohët e sotme, nocioni **aktivizëm gjyqësor**, përndryshe mjaft i përbuzur në diskursin publik, ngërthen në vetvete elemente përbërëse mjaft të ndryshme dhe më të strukturuara se koncepti që shprehet në togfjalëshin **ligjvënësi negativ vs ligjvënësi pozitiv**. Këta përbërës i diskutojmë në vijim të këtij seksioni. Para se të bëjmë këtë, në vazhdim japim një sqarim të shkurtër rreth dallimit në mes të cilësorit **aktiv** te togfjalëshi **gjyqësor aktiv** dhe emrit foljor **aktivizim** te togfjalëshi **aktivizim gjyqësor**, dallim ky që, në shikim të parë, mund të duket sikur bëhet fjalë për të njëjtin kuptim. Kjo, megjithatë, nuk është kështu. Te **gjyqësori aktiv**, fjala është për përshkrim të vëllimit të punës, përkatësisht për të treguar numrin e lëndëve që ka në punë një gjykatë në një kohë dhe hapësirë të dhënë. Në rastin e **aktivizmit gjyqësor**, ndërkaq, bëhet fjalë për **modus operandi** të një mekanizmi gjyqësor, të një gjykate apo të disa sosh, përkatësisht për tregimin e mënyrës sipas së cilës operon mekanizmi konkret gjyqësor, një gjykatë apo disa sosh.

Ky kapitull bën fjalë vetëm për **modus operandi**, përkatësisht shtjellon vetëm aktivizmin gjyqësor të gjykatave kushtetuese dhe atë nga aspekti skajshmërisht karahasimor. Kjo bëhet me qëllim të gjetjes së rolit dhe pozitës së gjyqësisë kushtetuese kosovare në sferën e aktivizmit gjyqësor.

Pikë referimi për të vlerësuar një gjë të tillë, pra për të vlerësuar **modus operandi** të gjykatave kushtetuese janë tekstet kushtetuese, ligjore dhe rregullativa e brendshme e gjykatës konkrete. Kjo do të thotë se pikë referimi për të vlerësuar **modus operandi** të një gjykate shërbejnë **parametrat** që një gjykatë i përdor për të vlerësuar lejueshmërinë e rasteve për gjykim dhe vendosje si dhe për vlerësim të vetë themëltësinë së kërkesave të paraqitura pranë saj për shqyrtim dhe vendosje. Kështu është rasti edhe me **Kosovën**: Kushtetuta, **Ligji Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës** (Ligji Nr. 03/L-121) dhe **Rregullorja e Punës së Gjykatës Kushtetuese** (RP) shërbejnë si pikë referimi për të vlerësuar nëse **Gjykata Kushtetuese** ka qenë apo është sot aktiviste, gjithnjë duke krahasuar këtë me praktikat dhe standardet tjera në **Evropë** dhe më gjerë.

Ekzistojnë edhe pika të tjera referimi për vlerësim të aktivizmit gjyqësor në përgjithësi, përveç atyre që kanë të bëjnë me parametrat për vlerësim të kushtetutshmërisë si më sipër. Në kontekstin kosovar, kjo nënkupton që aktivizmi i **Gjykatës Kushtetuese** nuk matet vetëm mbi bazën e praktikës së saj gjyqësore të ndërtuar gjatë interpretimit të Kushtetutës, zbatimit të **Ligji Nr. 03/L-121** dhe të **RP**, por edhe duke marrë parasysh faktorët tjerë shtesë. Këta faktorë shtesë kanë natyrë **ekstra-juridike** dhe kryesisht kanë të bëjnë me aspekte tjera rrethanore në të cilat jeton dhe vepron Gjykata. Kjo vlen edhe për gjyqësinë kushtetuese të vendeve tjera: krahas **faktorëve institucionalë**, siç janë dizajni institucional i përcaktuar me kushtetutë i gjyqësisë kushtetuese, numri i gjyqtarëve dhe profili i tyre dhe kështu me radhë, faktorët rrethanor çojnë mjaft peshë të madhe sepse lidhen me ambientin kulturor dhe tjetër në të cilin operon një gjykatë kushtetuese.

---

[3] Evgeni Tanchev, "Activism in Constitutional Review Revisited", a paper presented at the international conference organized by the Constitutional Court of the Republic of Latvia in cooperation with European Commission for Democracy through law (Venice Commission) (26-27 May 2016, Riga), fq. 267-304 në fq. 267-268. Në internet: http://www.satv.tiesa.gov.lv/en/wp-content/uploads/sites/2/2017/06/Book_Judicial-activism-of-the-ConstitutionalCo_urt-in-a-Democratic_State_ part _1 ENG.pdf (shikuar në shkurt 2019).

[4] Maartje de Visser, *Constitutional Review in Europe: A Comparative Analysis* (HART Publishing: Oxford and Portland, Oregon, 2015), fq. 283.

Në këtë kuptim, në literaturë, bazuar në hulumtimet empirike të 19 gjykatave kushtetuese të **ish-vendeve komuniste**, janë nxjerrë rezultatet mahnitëse, të cilat me një saktësi të madhe përcaktojnë faktorët me ndikim në të qenit aktiv të një gjykate kushtetuese. Këta faktorë janë ndarë në **faktorë institucional**, përkatësisht në faktor që kanë të bëjnë me **dizajnin institucional** të gjykatës përkatëse kushtetuese (lloji i juridiksionit kushtetues, pavarësia e garantuar me kushtetutë, numri i gjyqtarëve dhe përgatitja e tyre dhe kështu me radhë), në njërën anë dhe, në anën tjetër, në **faktorë ambiental apo rrethanor**, përkatësisht në faktorë që lidhen me ambientin apo rrethanat në të cilat operon gjykata kushtetuese, në rend të parë ambienti kulturor.[5] Hulumtimet po ashtu kanë treguar se aktivizmi gjyqësor nuk është domosdo i keq apo i mirë: çështja që shtrohet nuk është nëse duhet të ketë aktvizëm gjyqësor, por si të përdoret ai në mënyrë të dobishme.

Në këtë kapitull diskutojmë kryesisht **dizajnin institucional** që ka të bëjë me juridiksionin e gjykatave, si një shkak për aktivizëm gjyqësor, në ndërkohë që nga **faktorët rrethanor apo ambiental** veçojmë vetëm ata që janë më të zakonshëm dhe që kanë të bëjnë me periudhën transitore të post-konfliktit nëpër të cilën kalojnë gjykatat kushtetuese dhe shoqëritë ku operojnë ato, të cilat hyjnë në kategorinë e kulturës juridike dhe kushtetuese.

Pas mbarimit të komunizmit, aktivizmi gjyqësor ka qenë një **modus operandi** i shumicës së gjykatave kushtetuese. Është vlerësuar gjerësisht se ai ka qenë i domosdoshëm dhe i dobishëm sepse ka ndihmuar dukshëm në tejkalimin e tranzicionit post-komunist duke juridifikuar proceset politike dhe duke mbrojtur në mënyrë institucionale liritë dhe të drejtat kushtetuese, përkatësisht duke garantuar supremacinë (epërsinë) e kushtetutës si një akt normativ. Me kalimin e fazës kritike të tranzicionit post-komunist, hulumtimet po ashtu kanë treguar se ka ardhur deri te rënia graduale e aktivizmit gjyqësor të gjykatave kushtetuese.[6] Një trajektore e njëjtë e veprimit ka ekzistuar edhe në gjykatat kushtetuese të vendeve të Evropës pas mbarimit të **Luftës së Dytë Botërore**, të cilat u zunë në gojë më sipër.

T'i kthehemi tani rastit konkret të aktivizmit gjyqësor të në Kosovë dhe historikut të lindjes së këtij aktivizmi, i cili, duhet thënë që në fillim, ka qenë dhe ngelet i papërfillshëm krahasuar me vendet tjera ish-komuniste (p.sh. në krahasim me **Gjykatën Kushtetuese e Çekisë**, **Gjykatën Kushtetuese të Sllovakisë,**

---

5 Kështu, ta zëmë, në kuadër të **faktorëve institucional**, hulumtimet tregojnë si vijon: një gjykatë që ka juridiksion të gjerë është më e angazhuar se një tjetër që ka juridiksion të cunguar; pastaj, sa më shumë që ekziston përçarje në parlament, gjykata kushtetuese ka më shumë punë sepse opozita ngritë raste për t'i gjykuar gjykata; po ashtu, sa më shumë që kushtetuta njeh dhe garanton implementimin e lirive dhe të drejtave të njeriut përmes gjykatës kushtetuese, aq më shumë punë do të ketë për gjykatën e tillë kushtetuese dhe anasjelltas, etj. Ndër faktorët ambiental apo rrethanor vlen të përmendet që sa më afër të jetë një vend për integrim në **Bashkimin Evropian** (BE), aq më shumë punë do të ketë gjykata kushtetuese. Kjo është kështu sepse gjykata kushtetuese duhet të kontrollojë dhe sigurojë vënien në jetë të standardeve evropiane mbi sundimin e ligjit, të demokracisë dhe respektit për liritë dhe të drejtat e njeriut dhe kështu me radhë. Cf. më shumë për këtë në hulumtimin e Kirill M. Bumin, "Judicial Institutionalization and Judicial Activism of the Post-Communist Constitutional Courts" *Journal of Politics and Law* Vol. 10, No. 2 (2017) fq. 54-72; Për qasje të njëjtë, por të fokusuar vetëm në rastin e **Hungarisë** dhe **Polonisë**, cf. Jonathan Bond, "Concerning Constitutional Courts in Central and Eastern Europe " *International Public Policy Review* Vol. 2 No. 2 (November 2006) fq. 5-25 (sipas këtij autori, suksesi i gjykatave kushtetuese të **Hungarisë** dhe **Polonisë është përcaktuar nga përgjigja që ato iu kanë dhënë kontekseve institucionale dhe strukturore, të cilat janë vendosur gjatë punës së tyre. Kjo do të thotë, sipas këtij autori, se nuk është strategjia e vetëpërmbajtjes** ajo që përcakton suksesin dhe emrin e mirë të një gjykate, por gatishmëria për t'u ndeshur me sfidat që dalin nga struktura apo ambienti në të cilin operon gjykata kushtetuese, gjithnjë duke u bazuar në fuqinë e dizajnit institucional të cilin e posedon gjykata bazuar në kushtetutën nacionale).

6 Herman Schwartz, *The Struggle for Constitutional Justice in Post-Communist Europe* (The University of Chicago Press: Chicago, 200) fq. 265-279 (autori në këtë libër diskuton fillet e lindjes së gjyqësisë kushtetuese evropiane të modelit kelsenian, duke u fokusuar në **Bullgarinë, Hungarinë, Poloninë, Russinë** dhe **Sllovakinë**; të gjitha këto gjykata dhe përvojat e tyre në vitet e para pas themelimit janë hulumtuar në detaje, duke vënë në spikamë se jo domosdo aktivzmi gjyqësor ndërhynë dhe uzurpon pushtetin ligjvënës; si shembull për këtë autori merr rastin e **Gjykatës Kushtetutës të Hungarisë (GJKHu)**, e cila me të vërtetë i ka lënë hapësirë parlamentit të këtij vendi për të vepruar si ligjvënës sovran; pastaj diskuton për rolin aktivist të **Gjykatës Kushtetuese të Rusisë,** në përmasa dramatike, që ka ndodhur si rezultat i kulturës juridike ruse dhe i vetë kontekstit socio-politik të këtij vendi gjatë kohë së Presidentit **Jelcin (Boris Yeltsin: 1931-2007);** një situatë e ngjashme ka qenë edhe në **Sllovaki** në kohën e kryeministrit **Meciar (Vladimír Mečiar: 1942-)** dhe kështu me radhë; në përgjithësi, autori nuk është kundër aktivizmit gjyqësor, por kundër mënyrës së përdorimit të tij të padobishëm; në veçanti në sferën e lirive dhe të drejtave kushtetuese, aktivizmi i gjykatave kushtetuese ka qenë i dobishëm dhe ka luajtur një rol të rëndësishëm në promovimin dhe ruajtjen e tyre).

Gjykatën Kushtetuese të Hungarisë, Gjykatën Kushtetuese e Rusisë etj.).[7] Kjo gjendje e papërfillshme me aktivizmin gjyqësor kosovar nuk ka qenë diçka e pritur: autorë me origjinë nga **Kosova** kanë shënuar se qysh gjatë hartimit të **Ligji Nr. 03/L-121** ka pasur debate të gjalla lidhur me atë nëse duhej lejuar instituti i tërheqjes së kërkesës nga pala. Kjo dilemë ka lindur si pasojë e fakti se rëndësia publike (e përgjithshme) e kontesteve kushtetuese, pas ngritjes së tyre në Gjykatën Kushtetuese, tejkalon caqet e interesit privat të ngritësit të tyre. Kjo nënkupton më tutje, se pala që ka ngritur një kërkesë kushtetuese, nuk mund të detyroj Gjykatën për të heshtur lidhur me çështjen e ngritur njëherë në mënyrë ligjërisht të rregulltë.[8] Pikërisht për këtë arsye, në fund është gjetur një kompromis, gjithnjë sipas burimit me origjinë kosovare si më sipër. Ai kompromis ankorohet në nenin 23 të **Ligji Nr. 03/L-121**, dhe lejon palën për të tërhequr kërkesën deri në nisjen e mbledhjes plenare. Kjo, megjithatë, në asnjë mënyrë nuk e pengon Gjykatën për të dhënë verdiktin e saj lidhur me kërkesën, nëse një gjë të tillë e kërkon interesi publik (i përgjithshëm).[9] Kjo në vetvete paraqet një lloj leje për aktivizëm gjyqësor, një frikë që ka qenë në themel të arsyes së debatit të dendur gjatë hartimit të **Ligji Nr. 03/L-121**: në atë kohë, sipas burimeve të literaturës, ka ekzistuar frika se mospërcaktimi i saktë i caqeve të vendimmarrjes së **Gjykatës Kushtetuese** mund të çojë në veprime aktiviste të natyrës **ultra vires**, të cilat nuk përkojnë me përmbajtjen e kërkesës (**petitumi**) së palëve në procedurë.[10]

Kjo si më sipër, megjithatë, nuk ka qenë arsyeja për aktivizmin gjyqësor në gjyqësinë kushtetuese kosovare, por as në ato vende ku gjykatat kushtetuese gëzojnë të drejtën për t'u vënë në lëvizje **sua sponte** (me vetiniciativë). Krahas faktorëve institucional të përshkruar si më sipër, kanë qenë dhe ende janë disa faktorë të tjerë **ekstra-kushtetues** dhe **ekstra-ligjor**, të cilët po ashtu kanë ndikuar në aktivizmin gjyqësor të gjykatës së dhënë kushtetuese, përfshirë këtu ndikimin e tyre në caqet e këtij aktivizmi. Këto dhe çështjet që lidhen me faktorët përcaktues të aktivizmit gjyqësor, institucional dhe rrethanor, i diskutojmë në seksionet në vijim. Përzgjidhja e temave rreth aktivizmit gjyqësor, shkaqeve dhe natyrës së tij, është bërë pa ndonjë pretendim që të përfshihet secili aspekt i këtij fenomeni të gjyqësisë kushtetuese. Ajo përzgjedhje mëton të jep një pasqyrë sa më themelore për konceptet kyçe të aktivizimit gjyqësor, lindjen dhe kuptimin e tij, shkaqet dhe natyrën e tij si dhe për aspekte të tjera të ndërlidhura me te.

Në vijim si më sipër, seksioni i parë mëton të sqaroj kuptimin e zakonshëm të aktivizmit gjyqësor, për t'u pasuar nga seksioni i dytë që flet aktivizmin gjyqësor në sferën e juridiksionit material të gjykatave kushtetuese, përfshirë këtu rastin e **Kosovës**. Kjo do të thotë se nga faktorët institucional që i takojnë dizajnit kushtetues kosovar të gjyqësisë kushtetuese kemi përzgjedhur vetëm faktorin juridiksional.

I treti seksion merret po ashtu me sferën e juridiksionit si pjesë e dizajnit institucional të gjyqësisë kushtetuese, këtë herë me juridiksionin në sferën procedurale, sepse nganjëherë në këtë formë shprehet aktivizmi gjyqësor në disa vende evropiane dhe më gjerë, përfshirë **Kosovën**.

I lidhur ngushtë me konceptin e aktivizmit gjyqësor është koncepti i **vetëpërmbajtjes gjyqësore**, i cili, në fakt, paraqet antipodin e tij. Për këtë flasim në seksionin e katërt. Ky koncept përbën fenomenin gjyqësor kundruall të cilit qëndron aktivizmi gjyqësor. Në njëfarë mënyre, vetëpërmbajtja gjyqësore është pasqyra që matë aktivizmin gjyqësor të një gjykate konkrete.

---

7 Për një analizë të thukët dhe të shkëlqyer të lindjes dhe zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese në vendet ish-komuniste, përfshirë aktvizimin e tyre gjyqësor të theksuar, cf. më shumë në Herman Schwartz, *The Struggle for Constitutional Justice in Post-Communist Europe;* Radoslav Prochazka, *Mission Accomplished. On Founding Constitutional Adjudication in Central Europe* (Central European University Press: Budapest, 2002).

8 Visar Morina, "The Newly Established Constitutional Court in Post-Status Kosovo: Selected Institutional and Procedural Concerns". *Review of Central and East European law Vol.* 35 Issue 2 (2010) fq. 129-158 në fq. 150.

9 Neni 23 ["Tërheqja e palës"] Ligji Nr. 03/L-121:
"Gjykata Kushtetuese do të vendosë për çështjet që u janë referuar në mënyrë ligjore nga ana e palëve të autorizuara pavarësisht tërheqjes së palës nga procedura".

10 Visar Morina, "The Newly Established Constitutional Court in Post-Status Kosovo: Selected Institutional and Procedural Concerns", fq. 150-151.

Ka shumë rëndësi për lexuesin të thuhen disa fjalë lidhur **teknikat tjera të interpretimit**, përveç atyre që lidhen me aktivizmin gjyqësor si **modus operandi**. Këto teknika diskutohen në seksionin e pestë. Ato shërbejnë si një faqe tjetër e përbërësve të fenomenit të aktivizmit gjyqësor. Kemi fjalën për konceptet siç janë, ta zëmë, **prezumimi i kushtetutshmërisë së ligjeve**, **parimi i subsidiaritetit** etj., si matës i shkallës së aktivizmit në një rast apo mosmarrëveshje konkrete.

Në seksionin e gjashtë diskutohet **kultura juridike** si shkak për aktivizëm gjyqësor dhe si arsye për keqkuptime lidhur me atë se çka përbën aktivizëm gjyqësor të një gjykate kushtetuese.

Fare në fund, dy seksionet e fundit i rezervohen, si te kapitujt tjerë, komenteve dhe pyetjeve dhe literaturës shtesë, vec asaj të përdorur për prodhimin e këtij kapitulli, të cilën lexuesit duhet ta konsultojnë me qëllim të thellimit të dijeve të tyre në lëmin e aktivizmit gjyqësor në përgjithësi.

14.1. Kuptimi i zakonshëm i aktivizmit gjyqësor

Termi **aktivizëm gjyqësor** u farkëtua nga historiani dhe kritiku i njohur amerikan **Arthur M. Schlesinger Jr**., në një shkrim të tij të botuar në revistën **Fortuna** në janar të vitit 1947. Termi në fjalë nuk u përdor për herë të parë nga një gjyqtar apo jurist, por nga një person i profesionit tjetër dhe atë në një revistë jo-juridike që kishte për lexues një komunitet laik.[11]

Si fenomen i paemërtuar, ndërkaq, aktivizmi gjyqësor ka ekzistuar në sistemin e të **drejtës së përgjithshme** edhe para shekullit XX, gjë që dëshmohet nga përdorimi i termave **ligjvënie gjyqësore** ("judicial law-making") ose **e drejta e krijuar nga gjykata** ("judge-made law"),[12] me fillim që nga vërejtja e **John Marshall**, kryegjyqtar amerikan në rastin **Marbury vs Madison**, i cili thoshte se "[...] çdoherë duhet pasur parasysh se është Kushtetuta ajo që ne interpretojmë".[13] Tetë dekada më vonë, kësaj qasje iu kundërvu **realizmi legal**, eksponent i të cilit ishte gjyqtari **Oliver Wendell Holmes Jr.,** i cili fokusin e interpretimit gjyqësor e vuri te e drejta e përgjithshme, jo të ajo e shkruar. As njëri e as tjetri, megjithatë, nuk po flisnin për aktivizëm gjyqësor apo për konceptet e tij periferike, siç është origjinalizmi si mënyrë interpretimi apo edhe vetë koncepti i **realizmit legal.**

U mor vesh, në kohën që po flasim, kushtetutat më shumë kanë pasur karakter programatik, jo karakter normativ siç e kuptojmë ne sot: historikisht shikuar, ato janë kuptuar si pakte në mes të mbretit dhe shtresave të tjera, ku çdoherë një hapësirë prerogativash është ruajtur në favor të monarkut. Me nxjerrjen e kushtetutave të para të shkruara, në rend të parë në **SHBA**, kushtetutat nisën të marrin formën dhe rëndësinë e dokumenteve që kanë rol për të luajtur në formësimin e krejt strukturës politike.[14] Më vonë, këtij segmenti i shtohet edhe roli dhe rëndësia e kushtetutave në definimin e rolit dhe pozitës së individit në shoqëri, duke ofruar garancione efektive normative të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të tyre kushtetuese. Kjo ka ndodhur shumë më vonë, pas tragjedisë së **Luftës së Parë Botërore**.

---

[11] Ky autor, megjithatë, nuk e kishte definuar se çfarë nënkuptohet me këtë term. Cf. Mark Franek, "Judicial Activism. A Tempest or a Tempest in a Teapot?" *The Philadelphia lawyer* (Summer 2014) fq. 40-42 në fq. 40. Në internet: http://www.philadelphiabar.org/WebObjects/PBAReadOnly.woa/Contents/WebServerResources/CMSResources/TPL_Summer14_Teapot.pdf (shikuar në shkurt 2019); Cf., po ashtu, Keenan D. Kmiec, "The Origin and Current Meanings of Judicial Activism". *California Law Review* Vol. 92 No. 5 (October 20024) fq. 1441-1477 në fq. 1445-1450.

[12] Ibid., fq. 1444-1445.

[13] Maria Lúcia Amaral, "Judicial activism of European Constitutional Courts: does it really exist?", a paper presented at the international conference organized by the Constitutional Court of the Republic of Latvia in cooperation with European Commission for Democracy through law (Venice Commission) (26-27 May 2016, Riga), fq. 337-341 në fq. 339. Në internet: http://www.satv.tiesa.gov.lv/en/wp-content/uploads/sites/2/2017/06/ BookJudicial-activism-of-the-Constitutional-Court-in-a-Democratic State_ part _1 ENG.pdf (shikuar në shkurt 2019).

[14] Massimo La Torre, "Between Nightmare and Noble Dream: Judicial Activism and Legal Theory". Në Luís Pereira Coutinho, Massimo La Torre & Steven D. Smith (eds.), *Judicial Activism. An Interdisciplinary Approach to the American and European Experiences* (Springer International Publishing: Switzerland 2015) fq. 3-13 në fq. 4-6 & 10-13.

Kjo nuk do të thotë se më herët nuk kanë ekzistuar disa përvoja rudimentare të vënies në jetë të normave kushtetuese mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, si dhe lidhur me aspektet e caktuara të zgjidhjes së konflikteve kushtetuese të natyrës shtetërore. Këtu e kemi fjalën në rend të parë për përvojën gjermane sipas **Kushtetutës së Rajhut Gjerman** të vitit 1849.[15] Ka qenë përfundimi i **Luftës së Parë Botërore**, megjithatë, koha kur u krijua ambienti shoqëror e intelektual i volitshëm për të kërkuar një arbitër të tretë me detyrë që të gjykojë në mënyrë efektive rastet e cenimit të normave kushtetuese, norma që gëzonin supremacinë (epërsinë) normative në raport më çdo normë tjetër. Ai arbitër u gjet nga **Hans Kelsen** (Hans Kelsen: 1881-1973), në **Austrinë** e pas Luftës së Parë Botërore, për t'u kopjuar në Çekosllovakinë e asaj kohe. Në shtjellimet e veta teorike, tanimë të diskutuara gjatë kapitujve pararendës, **Hans Kelsen** shtjelloi deri në detaje tezën mbi gardianin e kushtetutës, si një pushtet kushtetues i konstituar dhe i ndarë nga tri pushtete tjera, që për qëllim parësor ka sigurimin e epërsisë (supremacisë) së normave kushtetuese përmes kontrollit kushtetues të ligjeve dhe produkteve të tjera të organit përfaqësues. Nga juridiksioni i gjykatave kushtetuese, **Hans Kelsen** përjashtoi liritë dhe të drejtat e njeriut dhe kontrollin e kushtetutshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare: të parat me arsyetimin se ato nuk përbëjnë të drejta subjektive të sanksionuara nga rendi objektiv juridik, kurse të dytat për shkak se do të përbënte një pengesë serioze për komunikimin ndërkombëtar të shteteve dhe do të shkaktonte pasiguri të madhe në këtë komunikim.

Si standard normativ me një gamë të madhe të juridiksionit kushtetues, që përfshijnë thuajse të gjitha sferat e jetës shoqërore në një shtet, gjyqësia kushtetuese u bë vetëm pas vitit 1945. Ky ndryshim rrënjësor në natyrën e të drejtës kushtetuese dhe të vetë rolit dhe rëndësisë së kushtetutave nacionale erdhën si rezultat i transformimit të së drejtës kushtetuese të kësaj kohe. Normat kushtetuese tanimë nuk mund të gjykoheshin më si struktura deduktive programatike, siç kishin besuar **pozitivistët** e kohës së kodifikimeve të mëdha të fundit të shekullit XVIII dhe shekullit të XIX, por si produkte që duheshin interpretuar përmes rregullave standarde të interpretimit dhe argumentimit juridik. E thënë me fjalë të tjera, teksti i kushtetutës nuk merret si program me mesazh të qartë, kuptimi i të cilit mund të nxirrej (deduktohej) nga leximi i zakonshëm, por si një strukturë normative me fuqi për të imponuar një lloj të caktuar të sjelljes, interpretimi i së cilës kërkonte teknika të tjera interpretimi që nuk mund të reduktohen në deduksion të thjeshtë.

Ky proces ka vazhduar çdo ditë e më shumë si pasojë imediate e rritjes së normativizmit në të drejtën kushtetuese, gjë që ka pasur për pasojë edhe rritjen e kompetencave brenda juridiksionit kushtetues: sa më shumë që kushtetutat kanë fituar forcë normative, thuajse gati në të gjitha sferat e jetës shoqërore, aq më shumë është rritur hapësira për reflektim të kësaj force në menynë e juridiksionit të gjyqësisë kushtetuese. Kjo, për pasojë, ka rritur kuadrin institucional për **aktivizëm gjyqësor**. Kjo rritje, thënë ndryshe, ka rezultuar si pasojë e rritjes së kompetencave juridiksionale të gjyqësisë kushtetuese dhe, së bashku me këtë, ka pasuar edhe rritja e hapësirës për aktivizim si teknikë interpretimi që shkon përtej interpretimit dhe argumentimit dogmatik lidhur me (dhe për) tekstin ekzistues kushtetues.

Rezervat dhe mëritë ndaj gjyqësisë kushtetuese nuk kanë ekzistuar në fillim të lindjes së saj: në fillim, termi **aktivizëm gjyqësor** asocohej me aktivistë dhe aktivizëm për të drejtat civile, më shumë se me gjyqësorin dhe gjyqtarin që abuzon me autoritetin e dhënë për të gjykuar dhe vendosur.[16] Vetëm me lindjen e gjyqësisë së ndarë kushtetuese pas **Luftës së Parë Botërore,** e cila për kompetencë parësore kishte kontrollin abstrakt të normës juridike, nisën rezervat dhe mëritë e para. Kjo për shkak se ky lloj i gjyqësisë për nga natyra e vet lente hapësirë të madhe për aktivizëm gjyqësor dhe, për pasojë, për rritjen e rezervave dhe mërisë ndaj konceptit praktik të aktivizmit gjyqësor. Në fakt, kuptimi i parë i aktivizmit gjyqësor lidhet me ligjvënien gjyqësore, përkatësisht me shpalljen të pavlefshme dhe anulimin e ligjeve të parlamentit. Kjo ka të bëjë me të a.q. **ligjvënie negative**.

---

[15] Për një studim analitik të zhvillimit të konstitucionalizmit gjerman përgjatë shekullit XIX deri te **Kushtetuta e Vajmarit**, rolin dhe pozitën e **Tribunalit Arbitral të Konfederatës** (1849) dhe të **Reichsgericht** apo **Gjykatës Supreme të Rajhut**, të cilat kanë ekzistuar në këtë periudhë, cf. më shumë në punimin e Oliver Jouanjan, "Aprecu d'une historie des fonctions de justice constitutionnelle en Allemagne (1815-1933)". Në Constance Grewe, Oliver Jounjan, Eric Maulin, Patric Wachsmann (eds.), *La notion de "justice constitutionnelle"* (Dalloz: Paris, 2005) fq. 13-48 në fq. 13-39.

[16] Keenan D. Kmiec, "The Origin and Current Meanings of Judicial Activism", fq.1451.

Kjo si më sipër, megjithatë, nuk do të thotë se aktivizmi gjyqësor ekziston çdoherë kur një gjykatë ushtron kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së normave juridike dhe kontrollin e kushtetutshmërisë së akteve të tjera të autoriteteve publike. **Ekziston aktivizmi gjyqësor atëherë kur gjykata tejkalon në mënyrë të qartë mandatin kushtetues dhe ndërhyn në politikat dhe punët e degëve tjera të pushtetit të përcaktuara me kushtetutë**. Kjo nënkupton se juridiksioni kushtetues, përkatësisht dizajni institucional konkret paraqet parametrin fillestar për të gjykuar nëse ekziston aktivizmi gjyqësor i një gjykate kushtetuese. Këta parametra juridiksional të mandatit kushtetues mund t'i referohen si të drejtës kushtetuese materiale ashtu edhe të drejtës kushtetuese procedurale. Edhe parametrat juridiksional, për pasojë, mund të jenë të natyrës juridiko-kushtetuese materiale (p.sh. dispozitat mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, organizimin dhe ndarjen e pushtetit etj.) dhe të natyrës juridiko-kushtetuese procedurale (p.sh. mosshterja e mjeteve juridike, shumicat e caktuara të kualifikuara për zgjedhjen e organeve kushtetuese dhe shkelja e tyre, afatet kohore për formimin e organeve shtetërore etj.).

Si parametër tjetër matës i shkallës së aktivizmit gjyqësor shërben edhe intensiteti dhe vëllimi i ndryshimit të **precedentëve të mëparshme** të një gjykate kushtetuese. Jo vetëm kaq! Si aktivizëm konsiderohen edhe rastet kur ekziston shmangie nga metodologjia e pranuar e interpretimit të kushtetutës duke përdorur parametra të tjerë të kontrollit të kushtetutshmërisë, si dhe atëherë kur gjykimi kushtetues orientohet kah arritja e një rezultati të caktuar, në injorim të tërësishëm të kushtetutës dhe parametrave matës të kushtetutshmërisë, përfshirë këtu precedentët e mëparshëm.

Në të gjitha këto raste, kur bëhet matja e aktivizmit gjyqësor çdoherë bëhet fjalë për analizën e procesit të silogjizmit gjyqësor, përkatësisht për analizimin e operacionit mendor (intelektual) që ka dy premisa: premisën e sipërme (**premisa major**) dhe premisën e poshtme (**premisa minor**).

Si **premisë e sipërme** në një gjykim kushtetues paraqitet norma kushtetuese apo një parametër tjetër saktësisht i definuar ose i definueshëm në aspektin kushtetues (ligji kushtetues, parimet, historia dhe ideologjia kushtetuese dhe nacionale, identiteti nacional dhe kushtetues, marrëveshjet dhe dokumentet relevante ndërkombëtare dhe kështu me radhë), kurse si **premisë e poshtme** çdoherë paraqitet një fakt jetësor që subsumohet nën premisën e sipërme, fakt që ka të bëjë kryesisht me sjelljet e pushtetit shtetëror apo të autoriteteve publike relevante (kjo përfshinë edhe situatat kur vlerësohet kushtetutshmëria e sjelljeve të individëve privat sepse në instancë të fundit autoriteti shtetëror apo autoritetit tjetër publik bën vlerësimin e sjelljeve të tilla, gjë që paraqet të a.q. **efekt horizontal të kushtetutshmërisë**). E thënë me fjalë të tjera, **silogjizmi** në gjyqësinë kushtetuese nënkupton procesin e nënvënies së fakteve apo rrethanave të caktuara materiale nën një normë apo parametër tjetër matës me qëllim të vlerësimit nëse faktet apo rrethanat e tilla materiale përshtaten me normën apo parametrin tjetër matës që ka natyrë abstrakte.

Në këtë proces, objekt kontrolli kushtetues është një veprim i një organi shtetëror apo publik, i cili, në të njëjtën kohë, përfaqëson **premisën e poshtme** të **silogjizmit gjyqësor**, kurse vetë kontrolli kushtetues përbën një mekanizëm procedural gjatë të cilit vlerësohen faktet apo rrethanat jetësore që gjenden brenda objektit të kontrollit kushtetues dhe që janë me relevancë kushtetuese. Krejt kjo bëhet me qëllim që të vërtetohet nëse të **njëjtat fakte kushtetuese** pajtohen me normën kushtetuese apo me standardin tjetër kushtetues që shërben si parametër matës i tyre. Ky parametër matës shërben si **premisë e sipërme**, e cila ngërthen si të drejtën materiale ashtu edhe të drejtën procedurale kushtetuese dhe gjendet e koncentruar në pjesën më të madhe në tekstin nacional kushtetues, por mund të gjendet edhe në tekste e dokumente të tjera të karakterit kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe në standarde të tjera kushtetuese. Çka përfaqëson, atëherë, **premisa e poshtme**? Ajo çdoherë paraqet objektin e kontrollit kushtetues, brenda të cilit gjenden të stampuara faktet apo rrethanat jetësore që kanë relevancë kushtetuese (**faktet kushtetuese**), përkatësisht veprimet ose mosveprimet e autoriteteve publike të një vendi.

E drejta e gjykatave kushtetuese për të vënë në jetë këtë drejtë kushtetuese (materiale dhe procedurale) me rastin e vendosjes për rastet dhe mosmarrëveshjet konkrete kushtetuese përbën juridiksionin e tyre kushtetues. Sa më shumë që është rritur juridiksioni i gjykatave kushtetuese, aq më tepër janë shtuar rezervat dhe neveritë e publikut dhe të shoqërisë ndaj gjyqësisë kushtetuese. Kjo duket qartë nëse me kujdes

analizohet zhvillimi i gjyqësisë kushtetuese përgjatë katër valëve të përhapjes, të diskutuara më herët,[17] në veçanti pas vitit 1945. Vala e fundit e përhapjes së gjyqësisë kushtetuese në vendet ish-komuniste, pas rënies së **Murit të Berlinit**, vetëm sa vërteton këtë konstatim: këto gjykata zakonisht kanë shkuar duke zgjeruar juridiksionin e tyre, duke fituar të drejtën e vendosjes për çështje kushtetuese të të gjitha sferave të jetës dhe punës së organeve shtetërore dhe të autoriteteve tjera publike. Ky zgjerim domosdo ka shtruar nevojën e gjetjes së përgjigjes në pyetjen: a është i domosdoshëm aktivizmi gjyqësor? Nëse përgjigja është afirmative, atëherë si duhet përdorur këtë fenomen në mënyrë të mençur për të çuar përpara idetë fundamentale të konstitucionalizmit modern, siç janë pengimi i pushtetit për të dalur nga kornizat juridiko-kushtetuese dhe sigurinë që interesi i individëve, i lirive dhe i të drejtave të tyre kushtetuese, përbën premisën themelore të origjinës së pushtetit politik, formës dhe organizimit të tij në praktikë.

14.2. Dizajni institucional dhe faktorët ambientalë (rrethanorë) si shkaqe të aktivizmit gjyqësor

Gjeneza e aktivizmit gjyqësor lidhet me ushtrimin e njërës prej kompetencave kryesore të gjykatave kushtetuese - kompetencën e kontrollit abstrakt të normës juridike. Kjo kompetencë përbën funksionin primar dhe definues të gjykatave kushtetuese, e cila që nga lindja e vet për qëllim primar ka pasur sigurimin e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës kundrejt normave tjera të përgjithshme përmes kontrollit të kushtetutshmërisë së normave abstrakte. Edhe ekzekutimi i të gjitha kompetencave të gjykatave kushtetuese shpie në të njëjtën rrugë, rrugën e sigurimit të supremacisë (epërsisë) së kushtetues kundrejt çdo akti tjetër juridik. Në mesin e kompetencave, megjithatë, **kontrolli abstrakt i normës juridike** (ligjore dhe kushtetuese) zë një vend të spikatur dhe është ngushtë i lidhur me faktorët juridiksional, përkatësisht me dizajnin institucional të gjykatave kushtetuese.

Në kuadër të diskutimit të dizajnit institucional, përkatësisht të juridiksionit të gjykatave kushtetuese si shkak dhe arsye për aktivizëm gjyqësor, në fillim diskutojmë për kontrollin abstrakt të normave kushtetuese, pastaj të normave ligjore. Më pas preken shkarazi edhe kompetencat e tjera juridiksionale të gjykatave kushtetuese, gjatë ushtrimit të të cilave po ashtu vjen në shprehje aktivizmi gjyqësor.

Kah fundi i këtij seksioni flasim edhe për faktorët ambiental (rrethanor) si shkak i aktivizmit gjyqësor.[18]

Kjo që u tha më sipër vlen edhe për qasjen ndaj aktivizmin gjyqësor të gjykatave të tjera të rregullta që janë të barasvlefshme me gjykatat kushtetuese (gjykatat supreme apo gjykatat tjera më të larta në vend). Pa

---

17 Cf. seksioni katërt i kapitullit të dytë të librit.

18 Në kuptimin e plotë të aktivizmit gjyqësor dhe të shkaqeve të tij, në literaturë janë dhënë arsyetime që kanë **natyrë rrethanore** (ambientale) dhe që nuk lidhen vetëpërveti me dizajnin institucional. Ndër ato që më së shumti janë zënë në gojë si shkak për aktivizim të gjykatave kushtetuese, në të gjitha sferat, janë si vijon: e para, **aktivizmi gjyqësor** lind si pasojë e përpjekjeve të shoqërisë për të rikrijuar demokracinë kushtetuese pas një periudhe të sundimit autoritar diktatorial; në këto raste institucioni i qeverisë dhe i parlamentit shihen si të kompromentuara ashtu që gjykata kushtetuese ngelet si institucion i vetëm i besueshëm që duhet të restaurojë demokracinë kushtetuese përmes vendimmarrjes së saj; e dyta, përpjekjet e vazhdueshme të gjykatave kushtetuese për të penguar rikthimin e diktaturës dhe të regjimit autoritar, domosdo që ngritin nivelin e aktivizmit; kjo bën që, në të njëjtën kohë, mos të ketë konsistencë në interpretimin e normave kushtetuese; e treta**,** në këto vende ish-diktatoriale dhe në tranzicion, sistemi i lirive dhe të drejtave njerëzore shihet si një rend objektiv i parimeve të rendit total juridik, gjë që nënkupton se ato janë të dhëna me qëllim të zgjidhjes së problemeve të tanishme dhe të ardhshme të shoqërisë; e katërta, në vijim si më sipër, balancimi me rastin e gjykimit për liritë dhe të drejtat e njeriut paraqet një teknikë përmes së cilës përpiqet të arsyetohet, në aspektin metodologjik, karakteri politik i gjykimit kushtetues, si një instrument i përshtatshëm për të racionalizuar natyrën aktiviste të gjykatave kushtetuese në kohë tranzicioni dhe krizash të thella shoqërore; e pesta, për pasojë, balancimi në vendosjen lidhur me liritë dhe të drejtat e njeriut nuk përbën një rrezik për mbrojtjen dhe promovimin e tyre por, përkundrazi, një mjet që mbron dhe promovon të njëjtat; dhe, së fundi, e gjashta, balancimi si i tillë nuk paraqet alternativë të argumentimit, por një formë të domosdoshme të diskursit racional praktik të gjyqësisë kushtetuese me qëllim të transformimit të tërësishëm të shoqërisë në drejtim të një shoqëri që bazohet në demokraci, sundim të ligjit dhe respekt për të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve. Cf., më shumë për këtë, në Juliano Zaiden Benvindo, *On the Limits of Constitutional Adjudication Deconstructing Balancing and Judicial Activism* (Springer-Verlag: Berlin Heidelberg, 2010) (autori i referohet gjyqësisë kushtetuese në **Gjermani** dhe **Brazil**, mirëpo merr shembuj krahasues për të treguar arsyet objektive që zakonisht çojnë në lindjen dhe përligjësimin e aktivizmit gjyqësor në një shoqëri; ky studim është jashtëzakonisht teorik, nga këndi postmodern i dekonstruksionit të tekstit; në rastin konkret, me tekst nënkuptohet de-racionalizimi i aktivizmit gjyqësor dhe teknikës së tij kryesore, asaj të balancimit, e cila zbatohet si pjesë e jetësimit të parimit të proporcionalitetit në të gjitha situatat që lidhen me gjykimin e dy parimeve, vlerave apo interesave kundërthënëse kushtetuese).

pasur një emër të tillë, **aktivizmi gjyqësor**, në fakt, origjinën e ka në vetë pushtetin gjyqësor që ushtrohet nga gjykatat e rregullta. Këtë e kemi sqaruar me herët kur kemi folur në kapitujt pararendës për historinë e lindjes së gjyqësisë kushtetuese dhe të kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe veprimeve e mosveprimeve të tjera të pushtetit me qëllim të sigurimit të epërsisë (supremacisë) së kushtetutës. Këtu e kemi fjalën për shtjellimet tona rreth rastit **Marbury vs Madison**, i cili paraqet vendimin themeltar të kontrollit kushtetues të normës ligjore, ku fjalia kyçe dhe mendimi thelbësor i verdiktit ka pasur të bëj me sigurimin se e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës. Në këtë vendim, thënë ndryshe, është vënë në duke dhe në mënyrë të qartë se ligji themelor dhe më i lartë që komandon fuqi më të madhe juridike kundrejt ligjeve dhe normave tjera është **Kushtetuta e SHBA**-ve. Kjo nuk ka mund të ndodhë në rastin **Dr. Bonham** (1610) sepse aty nuk është bërë fjalë për kontrollin gjyqësor me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së kushtetutës, por për kontroll gjyqësor të veprimit të gjyqësorit anglez me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) të së **drejtës së përgjithshme**: në ndërtimin e kuptimit të ligjit anglez, sipas Sër **Edvard Kouk** (Sir Edward Coke: 1552-1634), kryegjyqtarit të këtij rast, **e drejta e përgjithshme** kontrollon aktet e parlamentit. Me kohë kjo doktrinë gjyqësore është braktisur ashtu që sot supremacia (epërsia) e parlamentit anglez përbën një standard të pranuar përgjithësisht.

Premisë themelore mbi bazën e të cilës ka lindur dhe është zhvilluar aktivizmi gjyqësor në dy anët e **Atlantikut** ka qenë dhe ngelet përpjekja për sigurimin e **supremacisë (epërsisë) së kushtetutës**, përkatësisht përpjekja për sigurimin e një hierarkie të normave juridike, ku kushtetuta, normat, vlerat dhe parimet e saj qëndrojnë në maje të majave. Kjo do të thotë se faktori themelor objektiv që ka ndikuar në lindjen dhe zhvillimin e aktivizmit gjyqësor lidhet **me cilësinë e normave dhe parimeve që normojnë materien kushtetuese**, përkatësisht me transformimin e kushtetutave në dokumente që i takojnë kategorisë normative me fuqi shumë më të madhe se ligjet e zakonshme. Cilësia e fuqisë sipërore e normave kushtetuese ka rëndësi të theksohet me këtë rast sepse jo çdo normë që normon materien kushtetuese ka një cilësi të tillë: në Britani dhe në vendet që modelohen sipas sistemit të saj juridik, ekzistojnë norma kushtetuese, që normojnë materien kushtetuese, mirëpo vlera e tyre juridike është e njëjtë me çdo normë tjetër ligjore.

Cilësia si më sipër normative e kushtetutave, domosdo që ka shtruar nevojën për vënien e një sanksioni dhe një mekanizimi për vënien e tyre në jetë, njëjtë sikur te rasti i ligjeve dhe akteve të tjera të përgjithshme juridike. Ai mekanizëm është gjetur në institucionin e gjykatës kushtetuese dhe në veprimtarinë e saj juridiksionale të përcaktuar saktësisht me kushtetutë si tërësi kompetencash të qarta kushtetuese.

Më pastaj, gjatë historisë së vet zhvillimore, **aktivizmi gjyqësor** ka rrëshqitur në sferat tjera të juridiksionit të gjykatave kushtetuese. Ai fenomen, thënë në mënyrë figurative, ka ikur për t'u ankoruar në mënyrë graduale edhe në sferat tjera të juridiksionit material kushtetues, siç janë: normat dhe parimet që kanë të bëjnë me klauzolën e përjetësisë, ndryshe të njohura si **dispozitat e paamendamentueshme kushtetuese** apo **amendamentet jo kushtetuese**,[19] normat dhe parimet kushtetuese që kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat e njeriut; parimet e caktuara kushtetuese që diktojnë përmbajtjen e normave tjera kushtetuese (ta zëmë, parimet që kanë të bëjnë me ndalimin e diskriminimit, barazinë para ligjit, shtetin laik dhe kështu me radhë); dhe, në fund, normat kushtetuese që janë zhvilluar aq shumë sa që sot janë kthyer në norma të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë (ta zëmë, **parimi i legalitetit** në procedurën penale, **ndalimi i veprimit retroaktiv të normës juridike**, rregulli **ne bis in idem** etj.). Në të gjitha këto raste nuk ka ndërruar premisa themelore: ekzistimi i hierarkisë së normave juridike dhe roli kryesor i gjykatave kushtetuese në interpretimi e tyre me qëllim të sigurimit të epërsisë (supremacisë) së normave kushtetuese kundrejt çdo norme tjetër juridike ka qenë dhe ngelet **shkaku kryesor institucional për aktivizëm gjyqësor**. Secili segment i juridiksionit material të gjykatës kushtetuese është i dhënë në funksion të sigurimit të kësaj supremacie (epërsie).

Sa më shumë që ka ndryshuar juridiksioni i gjyqësisë kushtetuese, aq më shuam është shtuar potenciali për aktivizëm gjyqësor. Ky faktor institucional ka shkuar krah për krah me faktorë të tjerë **ekstra-juri-**

[19] Cf. më shumë në seksionin 11.3.9 të kapitullit njëmbëdhjetë.

dik, përkatësisht rrethanor apo ambiental nën të cilët ka vepruar gjyqësia kushtetuese. Kështu, ta zëmë, pas përhapjes së fundit të **modelit kelsenian/evropian** të gjyqësisë kushtetuese në vendet ish-komuniste, kontrolli kushtetues i pushtetit të parlamentit dhe administratës shtetërore u konsiderua gjerësisht si fusha që më së shumti u asocua me aktvizmin gjyqësor të gjykatave të reja kushtetuese.[20] Në këto vende, në mënyrë të tërthortë, gjykatat kushtetuese kanë luajtur rolin e formësuesit të politikave nacionale duke shpallur si jo kushtetues dhe duke i anuluar ligjet dhe normat e përgjithshme të përfaqësuesit të sovranit. Me këto veprime, gjyqtarët kushtetues, në disa raste, kanë zëvendësuar pikëpamjet e tyre politike/publike me ato të ligjvënësit. Së paku, kështu është dukur në sytë e publikut. Kjo ka bërë që **aktivizmi gjyqësor** të paraqitet në të njejtën kohë si një teknikë interpretimi, por edhe si një filozofi pune e gjykatave të reja kushtetuese sepse ka ardhur deri të zëvendësimi i pikëpamjeve të organit përfaqësues (parlamentit) me ato të gjyqtarëve kushtetues sa i përket politikave publike.

Zëvendësimi i pikëpamjeve të gjyqtarit me ligjvënësin dhe pikëpamjet e tij ndodhë në praktikë për shkak se normat kushtetuese substanciale (ta zëmë, ato që kanë të bëjnë me klauzolën e përjetësisë, me liritë dhe të drejtat e njeriut, pastaj normat që shërbejnë si lider në përcaktimin e përmbajtjes së normave të tjera, si dhe normat që kanë zbatim të drejtpërdrejtë) nuk ofrojnë standarde të njëkuptimta dhe komplete për vendimmarrjen kushtetuese. Jo vetëm normat substanciale kushtetuese si më sipër, por as normat organizative dhe procedurale kushtetuese nuk ofrojnë një standard të tillë pa dy kuptime dhe tërësisht të kompletuar.[21] Në varësi të shkallës së këtij zëvendësimi të pikëpamjeve të gjyqtarëve me ato të ligjvënësit përcaktohet edhe intensiteti i aktivizmit gjyqësor të një gjykate. Nganjëherë ai intensitet merr përmasa dramatike të një **superligjvëni**e apo të një ushtruesi të **pushtetit konstitutiv** (**origjiner** dhe **derivativ**) nga ana e gjykatave kushtetuese. Përkundër faktit që gjeneza e fenomenit të aktivizmit gjyqësor ka nisur me konceptin e **ligjvënies negative**, në mënyrë graduale ai ka kaluar në uzurpime të tjera të pushtetit ligjvënës dhe kushtetutëbërës të sovranit (pushteti konstitutiv **origjiner)** dhe përfaqësuesit të tij (pushteti konstituiv **derivativ**). Në literaturë, këtë gjendje, një autor e ka shprehur në mënyrë lakonike si vijon: në vend të sintagmës **Ne, Populli**, tani kemi sintagmën tjetër: **Ata, gjyqtarët.**[22] Kjo sintagmë përshkruan zëvendësimin e pikëpamjeve të gjyqtarëve me ato të përfaqësuesit të sovranit dhe të vetë sovranit në sferën e normavënies (kushtetuese dhe ligjore).

Rrethana e ligjvënies negative të gjykatave kushtetuese, në veçanti në rastet kur bëhet fjalë për fizionominë **evropiane/kelseniane** të gjyqësisë kushtetuese, sot paraqet një fakt që merret si i mirëqenë dhe nuk kontestohet më nga askush. Kjo, megjithatë, nuk është e tëra: në juridiksionin material të gjykatave kushtetuese, në ndërkohë janë futur edhe çështje të tjera që në kohën e **Hans Klesen** as do të mund të ishin imagjinuar. Ndër to hyjnë, ta zëmë, juridiksioni kushtetues material lidhur me mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të garantuara me kushtetutë: në kohën e lindjes së gjyqësisë kushtetuese **evropiane/kelseniane** në mes të dy luftërave botërore, korpusi mbi liritë dhe të drejtat e njeriut është parë si një pjesë deklarative dhe programatike e kushtetutës që nuk mund të implementohet përmes rrugës gjyqësore. Realizimi i këtij korpusi nuk mund të bëhej përmes rrugës gjyqësore për shkak të natyrës dhe karakterit të tyre. Këtë fakt e ka shprehur më së miri njëri ndër apogjetët më të mëdhenj të veprës së **Hans Kelsen**, francezi **Charles Eisenmann**, i cili ka theksuar se "[...] liritë dhe të drejtat njerëzore kanë karakter politik ...; ato janë norma që nuk kanë sanksion dhe një organ që kujdeset për vënien e tyre në jetë **in concreto**".[23] E thënë ndryshe,

---

20 Ruti Teitel, "Post-Communist Constitutionalism: A Transitional Perspective" *Columbia Human Rights law Review* Vol. 26 No. 1 (1994) fq. 167-190 fq. 177-178.

21 Maartje de Visser, *Constitutional Review in Europe: A Comparative Analysis*, fq. 281.

22 Lisa Hilbink, "Assessing the New Constitutionalism". *Comparative Politics* Vol. 40 No. No. 2 (January 2008) fq. 227-245 në fq. 232.

23 Charles Eisenmann, *La justice constitutionnelle et la Haute cour constitutionnelle d'Autriche* (Librairie Générale de Droit & de Jurisprudence: Paris, 1928) fq. 94, 97. Sipas këtij autori, liritë dhe të drejtat e njeriut kanë statusin e normave kushtetuese, njëjtë si normat tjera, të cilat nuk mund të vihen në jetë përmes rrugës gjyqësore. Ato, gjithnjë sipas tij, nuk kanë karakter të të drejtave subjektive, si**ç** thonë autorët **Huriou (**Maurice Hauriou: 1856-1929) dhe **Diguit (**Léon Duguit: 1859-1928), sepse për të qenë të tilla ato duhet të jenë pjesë e të drejtës objektive që prodhohet me ligje nga ana e përfaqësuesit të sovranit. Kjo nënkupton se ato vetëm deklarativisht paraqiten në kushtetutë, për t'u konkretizuar siç duhet përmes ligjvënies së rregullt. Kjo do të thotë se ato thjeshtë kanë karakter politik-programatik. Cf. Ibid.fq. 93-99.

arsyeja pse korpusi i lirive dhe të drejtave të njeriut nuk kishte karakter normativ kishte të bënte me faktin se ato dispozita kushtetuese që normonin këtë korpus nuk ishin pjesë e një rendi objektiv juridik nga ku burojnë të drejtat subjektive të individëve dhe subjekteve të tjerë të së drejtës.

Më vonë, listës së juridiksionit material të gjykatave kushtetuese iu janë shtuar edhe kompetenca të tjera, si p.sh: kontrolli kushtetues i formimit dhe i veprimtarisë së partive politike, kontrolli kushtetues i mbajtjes së referendumeve, juridiksioni penal ndaj funksionarëve të larë shtetëror, **impechment**-i i shefit të shtetit dhe kështu me radhë. Jo vetëm kaq! Në kuadër të vetë juridiksionit klasik, kontrollit abstrakt të normës juridike, janë bërë inovacione, të cilat gjithashtu dukshëm tejkalojnë çdo parashikim të **Hans Kelsen** dhe autorëve të tjerë që promovuan themelimin e gjykatave të ndara kushtetuese në mes të dy luftërave botërore. Në mesin e këtyre inovacioneve që kanë të bëjnë me funksionin klasik të gjyqësisë kushtetuese, kontrollin abstrakt të normës juridike, dy veçohen në mënyrë të posaçme: e para, **kontrolli abstrakt i normës kushtetuese** (i amendamenteve kushtetuese); dhe, dy, **kontrolli kushtetues i ligjvënies së zakonshme** përtej caqeve të ligjvënies negative, duke çuar nganjëherë deri te prishja e vijës ndarëse në mes të gjykimit dhe ligjvënies si politikë, pikërisht ashtu siç kishte parashikuar **Karl Shmit (Carl Schmitt: 1888-1985),** kritiku i ashpër i gjyqësisë kushtetuese,[24] që kishte thënë se kontrolli abstrakt i normës domosdo shpie në politizim të gjyqësorit.[25] Kjo përbën formën më drastike të aktivizmit gjyqësor, historikisht shikuar.

Të shohim si duken këto dy sfera të inovacionit në kuadër të kontrollit abstrakt të normës juridike.

Në sferën e **pushtetit konstitutiv origjiner**, aktivizmi në gjyqësinë kushtetuese është më i rrallë, nisur nga fakti se pushteti konstitutiv nuk konsumohet asnjëherë me nxjerrjen e kushtetutës. Ai rri fjetur, thënë figurativisht, në intervalin kohor ndërmjet nxjerrjes së kushtetutës dhe amendamentimit të saj (momenti tjetër kur vjen deri të ushtrimi i këtij pushteti). Vlerësimi nëse një gjykatë kushtetuese është aktiviste në sferën e kontrollit abstrakt të normës kushtetuese bëhet duke marrë si parametër vetë dispozitat ekzistuese kushtetuese: **gjatë kontrollit të kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese në kushtetutën ekzistuese, gjykata vlerëson nëse këto amendamente cenojnë dispozitat kushtetuese që kanë status të paamendamentueshëm dhe cilësi të tjera të përshkruara si më sipër**.

Në secilën kushtetutë të demokracive kushtetuese liberale ekziston një lloj hierarki e normave kushtetuese, në krye të së cilës vijnë normat kushtetuese që definojnë **identitetin kushtetues** të një shoqërie, të cilat zakonisht janë të paamendamentueshme sipas vetë urdhrit kushtetues (**Gjermania** dhe shumica e vendeve që kanë dispozita të tilla kushtetuese) apo duke u bazuar në praktikën gjyqësore (p.sh. **India**). Në këtë kategori hyjnë, ta zëmë, dispozitat mbi origjinën e pushtetit politik, formën dhe organizimin e këtij pushteti, si dhe dispozitat mbi pozitën dhe rolin e individit në shoqëri. Ky lloj i dispozitave kushtetuese i takon prerogativave të sovranit që kanë të bëjnë me **pushtetin konstituiv origjiner**. Dispozitat tjera që nuk **prekin identitetin kushtetues**, përkatësisht dispozitat që normojnë cilësinë e origjinës së pushtetit politik dhe mënyrës së ushtrimit të tij, si dhe cilësinë dhe formën e organizimit i referohen ushtrimit të **pushtetit derivativ konstituiv.**

Kontrolli kushtetues i amendamenteve kushtetuese që kanë të bëjnë me ushtrimin e **pushtetit konstituiv origjiner** ka për bazë parametra të tjerë kushtetues, që jo rrallë tejkalojnë tekstin kushtetues duke u ankoruar në kritere matëse metafizike që kanë natyrë të ndryshme historike, morale, natyrë të imperativit historik me qëllim të farkëtimit të unitetit nacional, si dhe natyrë tjetër pragmatike që përmbushë nevojat momentale të shoqërisë. Ky nuk është rasti me kontrollin kushtetues të **pushtetit konstituiv derivativ**:

[24] Më së shumti aktivizmi gjyqësor vjen në shprehje në sferën e kontrollit të ushtrimit të pushtetit konstituiv dhe ligjvënës, përkatësisht në sferën e amendamenteve kushtetuese dhe ligjeve. Në këtë kategori hyn edhe kontrolli kushtetues i aktivitetit normativ të ekzekutivit dhe organeve të tjera të pushtetit qendror. Kjo në literaturë njihet si kontrolli kushtetues i parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Cf. Evgeni Tanchev, "Activism in Constitutional Review Revisited", fq. 272-273.

[25] Cf. më shumë për këtë në analizën elokuente të Miguel Nogueira de Brito, "Schmitt's Spectre and Kelsen's Promise: The Polemics on the Guardian of the Constitution". Në Luís Pereira Coutinho, Massimo La Torre & Steven D. Smith (eds.), *Judicial Activism.An Interdisciplinary Approach to the American and European Experiences*, fq. 89-104.

kontrolli kushtetues i amendamenteve kushtetuese, si ushtrimi më i zakonshëm i pushtetit konstituiv derivativ, bazohet në parametra që zakonisht nuk dalin nga teksti i kushtetutës që interpretojnë. Kjo nuk do të thotë se nuk mund të ndodhë që në emër të ushtrimit të këtij pushteti konstituiv të vij deri të ushtrimi i pushtetit konstituiv origjiner. Në fakt, jo rrallë ka ndodhur që të kryhen ndryshime kushtetuese radikale, që ndërpresin çdo lidhje me të kaluarën dhe paraqesin ushtrim të hapur të pushtetit origjiner konstituiv. I tillë ka qenë rasti, ta zëmë, me ndryshimet kushtetuese nëpër ish-republikat jugosllave në periudhën e viteve 1990-1992, kur u krijuan shtete e reja të pavarura dhe sovrane (Bosnje-Hercegovina, Kroacia, Serbia, Sllovenia, Mali Zi, dhe Maqedonia).

Të rastit të parë janë dispozitat kushtetuese që kanë të bëjnë me origjinën e pushtetit dhe sovranitetin nacional (p.sh. nëse ai pushtet ka origjinë hyjnore apo popullore), formën e shtetit (psh. nëse shteti është monarki apo republikë), organizimin e shtetit (psh. nëse shteti federatë apo shtet unitar), pozitën dhe rolin e individit në shoqëri (p.sh. nëse dispozitat mbi liritë dhe të drejtat e njeriut kanë karakter normativ apo janë thjeshtë deklarata programatike; garancionet dhe mekanizmat kushtetues për vënien në jetë të dispozitave kushtetuese që kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat e individit; mënyra e pjesëmarrjes së individëve në ushtrimin e pushtetit politik; mosdiskriminimi dhe vlerat tjera që lidhen me dinjitetin e njeriut dhe kështu me radhë). Të rastit të dytë, ndërkaq, janë dispozitat që kanë të bëjnë, ta zëmë, me mënyrën e zgjedhjes së organeve kushtetuese dhe kohëzgjatjen e mandatit të tyre, llojin dhe strukturën e sistemit të sigurisë, ushtarak dhe të drejtësisë, sistemin zgjedhor dhe kështu me radhë. Në këto raste, amendamentimi i kushtetutës **nuk prek identitetin kushtetues** të përcaktuar nga sovrani në fillim të ndërtimit të kushtetutës, fillim që jo rrallë koincidon me ndërtimin e shtetit. Në këtë kuptim, siç kemi theksuar më herët në një vend tjetër,[26] me kushtetutë nënkuptohet norma e parë (**grundnorm**), e mishëruar (shkrirë) në një vendim konkret politik me të cilën populli ushtron vullnetin e tij sovran lidhur me formën dhe përmbajtjen konkrete të ekzistencës së vet politike. Vetëm kjo konsiderohet ushtrim i pushtetit konstituiv origjiner që **prek identitetin kushtetues** të një shoqërie. Kjo përfshinë dispozitat e rastit të parë si më sipër.

Çdo tejkalim i parametrave të përshkruar si më sipër nga ana e gjykatës kushtetuese më rastin e kontrollit kushtetues të **amendamenteve kushtetuese** përbën aktivizëm gjyqësor. Në rastet kur tejkalimi ka të bëjë me **pushtetin origjiner konstituiv**, atëherë një gjë e tillë vërehet më dukshëm dhe më lehtë, se sa në rastet kur bëhet fjalë për kontrollin kushtetues të ushtrimit të **pushtetit konstitutiv derivativ**. Në rastin e fundit gjendja paraqitet më ndryshe sepse këtu është më vështirë për t'u vënë në dukje aktivizmi i gjykatës kushtetuese, nisur nga fakti se bëhet fjalë për çështje që nuk prekin apo nuk ndryshojnë vendimin ekzistencial të një shoqërie të organizuar në shtet, çështje që prekin cilësinë e qeverisjes dhe format e manifestimit të kësaj cilësie.

Të shohim në vijim si duken këto dy lloje të kontrollit kushtetues të pushtetit konstitutiv (**origjiner** dhe **derivativ**) në kontekstin kosovar. Shënojmë këtu se, deri më sot, në gjyqësinë kushtetuese në **Kosovë** nuk ka pasur ndonjë kontroll kushtetues të ushtrimit të **pushtetit konstitutiv origjiner**. Në publik ndonjëherë është dukur, në mënyrë të gabuar, se kanë ekzistuar raste të tilla të aktivizmit gjyqësor në vendimmarrjen e **Gjykatës Kushtetuese**. Këtu i kemi parasysh situatat me kontrollin kushtetues të amendamenteve kushtetuese që kanë pasur të bëjnë **përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur** në shtator të vitit 2012 dhe me kontrollin kushtetues të amendamenteve që themeluan **Gjykatën Speciale**. Në dy këto raste, megjithatë, fjala ka qenë për kontroll kushtetues të ushtrimit të **pushtetit konstitutiv derivativ**, jo të **pushtetit konstituiv origjiner**.

Në lidhje të ngushtë me këtë, ekzistojnë edhe tri raste kur në publik ka ekzistuar percepsioni i gabuar se Gjykata ka vepruar në kushtet e aktivizmit gjyqësor, gjë që po ashtu nuk ka qenë rasti.

[26] Cf. seksioni 10.3 i kapitullit të dhjetë (pjesa që flet për **Planin Ahtisari**, **Deklaratën e Pavarësisë** dhe mendimin e **GJND** për Kosovën.

Këto raste, megjithatë, nuk kanë të bëjnë fare me kontrollin abstrakt të normës por me dy kërkesa individuale[27] dhe më një kontroll kushtetues të vendimit të Kuvendit të Kosovës.[28]

Në rastin e përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur, Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se kishte ardhur koha për përfundimin e fazës së pavarësisë së mbikëqyrur të Kosovës, e cila bazohej në dispozitat përkatëse të **Planit Ahtisari**, për çka kemi folur në kapitujt pararendës.[29] Ky dokument, megjithatë, përmbante detyrime që ishin pjesë përbërëse e detyrimeve kushtetuese, të cilat, në të njëjtën kohë, kishin edhe karakter të detyrimeve të njëanshme ndërkombëtare që nga momenti i shpalljes së pavarësisë së Kosovës në 17 shkurt 2008. Si të tilla, këto detyrime më pastaj janë operacionalizuar deri në detaje me dispozitat relevante të Kushtetutës që kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat e komuniteteve, gjyqësinë kushtetuese, shumicën e dyfishtë kundër amendamentimit të dispozitave të ligjeve që prekin të drejtat e komuniteteve etj. etj.

Si parametër matës në rastin e kontrollit kushtetues të amendamenteve që kishin të bënin me **përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur** kanë qenë dispozitat e **Planit Ahtisari**, të cilat me rastin e vendosjes e kanë dërguar (referuar) Gjykatën Kushtetuese në dy drejtime: njëri ka qenë **drejtimi retrospektiv**, përkatësisht referimi dhe mbështetja në **grundnorm**-ën e Kosovës, e cila gjendet në **Deklaratën e Pavarësisë** së **Kosovës** (17 shkurt 2008), kurse tjetri ka qenë **drejtimi prospektiv**, i cili gjendet në dispozitat e Kushtetutës së vitit 2008 që flasin për epërsinë (supremacinë) e përkohshme të dispozitave të **Planit Ahtisari** gjatë kohës sa ka zgjatur pavarësia e mbikëqyrur. Në ndërkohë që baza juridike **retrospektive**, përkatësisht **grundnorm**-a e Kosovës ngelet në fuqi sot e kësaj dite dhe përbën kurrizin apo shtyllën fundamentale mbi të cilën qëndron identiteti kushtetues i Kosovës, baza juridike prospektive, përkatësisht dispozitat e Kushtetutës që garantonin supremacinë (epërsinë) e përkohshme të dispozitave të **Planit Ahtisari** janë shfuqizuar dhe i takojnë historisë. Si të tilla, ato dispozita kanë ndihmuar në formësimin e identitetit kushtetues aktual të Kosovës, por nuk kanë qenë kurrizi apo shtylla fundamentale mbi të cilën qëndron identiteti kushtetues i Kosovës së sotme.[30]

---

27 Këtu fjalën e kemi për rastet **Bajrush Gashi** (*Rasti KI 106/12. Aktgjykim. Parashtrues: Bajrush Gashi . Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, Pzd. nr. 67/2011, të 12 dhjetorit 2011.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 27 qershor 2012 . Nr. ref.:AGJ262/12) dhe **Bajrush Xhemajlit** (*Rasti KI 78/12. Aktgjykim. Parashtrues: Bajrush Xhemajli, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. Nr. 70/2012, të 22 qershorit 2012.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 24 janar 2013). Të shohim si duken këto dy raste në pika të shkurtra.
Në rastin e **Bajrush Gashit**, njëjtë si në rastin në vijim të Bajrush Gashit, objekt i çështjes ka qenë pretendimi për shkeljen e të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm nga neni 31 i Kushtetutës, për shkak se një gjyqtare e **Gjykatës Supreme**, **V. D**., kishte marrë pjesë në procedurat penale kundër parashtruesit të ankesës kushtetuese, të cilat ishin zhvilluar në Prizren, ku ishte dënuar. **Gjykata Kushtetuese** shpalli të pavlefshëm vendimin e **Gjykatës Supreme** që kishte shkelur të drejtat e parashtruesit të ankesës kushtetuese dhe e ktheu çështjen në rigjykim. **Gjykata Supreme** kishte argumentuar me shkrim se pjesëmarrja e gjyqtarit të saj dy herë në procedurat kundër personit të njëjtë, në shkallë të parë kur ishte dënuar dhe në shkallë të fundit kur kërkonte zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, kishte qenë e domosdoshme për shkak të numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve në Gjykatën Supreme. **Gjykata Supreme**, me fjalë të tjera, argumentoi se sikur të përjashtoheshin të gjithë anëtarët që kanë qenë të përfshirë në ndonjë fazë të procedurës, atëherë Gjykata Supreme nuk do të kishte gjyqtarë për të vendosur për kërkesën. Gjykata Kushtetuese, ndërkaq, konsideroi që çështja nëse ka apo nuk ka numër të mjaftueshëm të gjyqtarëve për të vendosur për kërkesat për zbutje të dënimit është çështje krejtësisht nën juridiksion, dhe për diskutim, po qe nevoja, ndërmjet gjyqësorit dhe Qeverisë. Përgjegjësia primare për administrimin e mirëfilltë të drejtësisë i takon Qeverisë dhe çështjet organizative nuk mund të përdoren si arsyetim për mosrespektim të Kushtetutës. Cf. më shumë paragrafët 32-52 dhe pjesa operative e Aktgjykimit në rastin **KI 106/12**.
Rasti i **Bajrush Xhemjlit** ka qenë si vijon: Parashtruesi pretendonte se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme kishte shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, neni 31 ["E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], për shkak se gjykatat e Kosovës nuk kishin marrë parasysh kërkesën e tij për superekspertizë, duke u kënaqur me provat ekzistuese, të cilat, sipas gjykatave, mjaftueshëm provonin fajësinë e tij. Gjykata Kushtetuese, megjithatë, nuk është pajtuar me këto gjetje të gjyqësorit të rregullt kosovar dhe ka vendosur që kishte pasur shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të dështimit të gjykatave për t'i lejuar kërkesat e parashtruesit të kërkesës për kundërekspertizë. Kjo ka çuar në cenimin e të drejtave të mbrojtjes dhe të ndershmërisë së krejt procedurave , ngase kanë privuar parashtruesin nga mundësia për të paraqitur argumente në mbrojtjen e tij në të njëjtat kushte si të prokurorisë. Cf. më shumë në paragrafët 68-106 dhe pjesën operative të Aktgjykimit në rastin **KI 78/12**.

28 Fjala është për **rastin Pacolli**. Cf. fus. 121, **infra**, në këtë kapitull, si dhe teksti që e shoqëron.

29 Cf. fusnotën nr. 26, **supra**, në këtë kapitull, si dhe tekstin që e referon për lexuesin.

30 Cf. fusnota nr. 26, **supra**, dhe tekstin që e referon për lexuesin. Cf. po ashtu edhe seksionin 11.2 të kapitullit të njëmbëdhjetë.

Gjendja nuk ndryshon aspak sa i përket themelimit të **Gjykatës Speciale** dhe kontrollit kushtetues të **amendamentit kushtetues nr. 24** (tani neni 162 i Kushtetutës). Këtë e kemi diskutuar gjerësisht në një vend vjetër.[31] Këtu mjafton të thuhet se parametri kryesor matës për kontrollin e kushtetutshmërisë së amendamentit si më sipër që themelon **Gjykatën Speciale të Kosovës** ka qenë dispozita e nenit 103.7 ["Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave"] të Kushtetutës. Teknika e vënies në jetë të dispozitës së nenit 103.7 të Kushtetutës ka qenë ajo e marrjes (akceptimit) të një detyrimi ndërkombëtar, bazuar në raportin tanimë të njohur si **Raporti Dick Marty**, i cili është shndërruar në një detyrim ndërkombëtar që ngërthehet si urdhër në një rezolutë të **Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës** (**AP** e **KE**). Kjo teknikë juridike ka qenë zinxhirore, duke marr në fund të realizimit të vet formën e një amendamenti kushtetues, **amendamentit nr. 24** (tani neni 162 i Kushtetutës së vitit 2008), që është miratuar në vijim të vënies në jetë të detyrimit si më sipër ndërkombëtar. Më këtë amendament, **Kosova** ka bartur në një shtet të tretë dhe në një organizatë të karakterit regjional, **BE**, një pjesë të sovranitetit të vet – sovranitetin në sferën e drejtësisë në të gjitha hallkat e tij (prokuroria, pushteti gjyqësor, gjyqësia kushtetuese, avokati i popullit dhe agjensionet e zbatim-ligjit, krejt kjo ekskluzivisht për aq sa i përket juridiksionit material të **Gjykatës Speciale të Kosovës**). Kjo bartje e këtij sovraniteti, megjithatë, nuk ka pasur për pasojë ndryshimin apo transformimin e identitetit kushtetues të Kosovës, nisur nga fakti se parametri bazë i kontrollit kushtetues ka qenë dispozitat e nenit 103.7 të Kushtetutës. Kjo do të thotë se, as në këtë rast, njëjtë si në rastin pararendës, nuk mund të bëhet fjalë për aktivizëm të Gjykatës Kushtetuese. Kjo, sikundër u tha më lart, në diskursin publik është konsideruar si aktivizëm gjyqësor, por nuk ka qenë i tillë.

Në vijim vazhdojmë me analizën tonë lidhur me atë nëse ka pasur aktivizëm gjyqësor në Kosovë me rastin e kontrollit kushtetues të amendamenteve kushtetuese. Kjo analizë ka rëndësi për faktin se amendamentet kushtetuese paraqesin ushtrim të pushtetit më sublim të përfaqësuesit të sovranit, **pushtetit derivativ konstituiv**, që në disa raste mund të ketë për pasojë ndryshimin e **identitetit kushtetues fillestar**. Për këtë arsye, ka shumë rëndësi që lexuesi të dijë teknikën e kontrollit kushtetues mbi ushtrimin e këtij pushteti si dhe parametrat që përdoren nga Gjykata Kushtetuese gjatë ushtrimit të kontrollit kushtetues në fjalë.

Në **Kosovë**, në praktikën e derisotme, në parim, si parametër matës kushtetues kanë shërbyer jo vetëm kapitulli II i Kushtetutës, ashtu siç thotë neni 13.9 ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] në lidhje me nenin 144.2 ["Amendamentimi"] të Kushtetutës, por edhe kapitulli III, germa e fryma e Kushtetutës ashtu siç është interpretuar nga Gjykata Kushtetuese. Në këtë sferë të vendimmarrjes kushtetuese, pra në sferën e kontrollit kushtetues mbi ushtrimin e **pushtetit konstitutiv derivativ**, në opinionin publik janë diskutuar disa prej vendimeve të **Gjykatës Kushtetuese**, të cilat ne i përfolim në vijim sa për të treguar nëse vërtet ka pasur aktivizim gjyqësor apo ka qenë fjala për një debat publik të politizuar për qëllime të politikës ditore me qëllim të dëmtimit të imazhit të Gjykatës. Shih për këtë arsye, vendimet janë ndarë në ato që vërtetë sipas çdo kriteri plotësojnë kushtin për t'u quajtur **vendime aktiviste** dhe në vendime që në mënyrë të gabuar dhe si pasojë e perceptimeve rutinë janë cilësuar si aktiviste, për shkak të mosnjohjes së teknologjisë së vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese. Vendimet e grupit të dytë, në fakt, u diskutuan më sipër.

Të grupit të parë, vendimet që sipas çdo kriteri plotësojnë kushtin për t'u cilësuar si aktivizëm gjyqësor, janë vendimet si vijon: rasti **Qeska,**[32] rasti i **ushtruesit të detyrës së Presidentit të Republikës,**[33]

---

31 Cf. seksioni 11.2 i kapitullit të njëmbëdhjetë.

32 *Rasti KO 80/10. Aktgjykim. Kërkesa e Presidentit të Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së tij Dr. Fatmir Sejdiu, për sqarim të kompetencave në rastin e kryetarit të Rahovecit, z. Qazim Qeska*. *Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës*. Prishtine: më 7 tetor 2010. Ref. nr. AGJ 46110 .

33 *Rasti Nr. KO 97/10 . Aktgjykim. Në çështjen e kërkesës së parashtruar nga Ushtruesi i Detyrës së Presidentit, Dr. Jakup Krasniqi, lidhur me mbajtjen e postit të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit dhe njëkohësisht të postit të Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Demokratike të Kosovës*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës** . Prishtinë: më 22 dhjetor 2010. Nr. Ref. AGJ 78/10.

rasti i **imuniteteve të deputetëve dhe të funksionarëve të lartë shtetëror,**[34] rasti i **pensioneve të FSK-së,**[35] rasti **VLAN-i,** [36] dhe, së fundi, **rasti i Asociacionit Serb**.[37]

Në **rastin Qeska**, Gjykata ka konstatuar se ka kompetencë lëndore, **ratione materiae**, për të vlerësuar kushtetutshmërinë e dorëheqjes së kryetarit të komunës sepse akti dorëheqjes i jep fund mandatit të kryetarit të komunës dhe, për pasojë, aktivizon liritë dhe të drejtat kushtetuese nga neni 123. 2 [Qeverisja Lokale dhe Organizimi Territorial: Parimet e Përgjithshme"] lidhur me nenin 45.2 ["Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes"] të Kushtetutës, të interpretuara në dritën e dispozitës së nenit 3.2 ["Koncepti i Vetëqeverisjes Lokale"] të Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale (1985).[38] Thënë me fjalë të tjera, Gjykata Kushtetuese ka ardhur deri të përfundimi se "[…] dorëheqja e cilitdo kryetar komune është përfundimtare dhe definitive dhe i jep fund mandatit të kryetarit të komunës". Ky veprim prodhon pasoja kushtetuese, me kuptim që duhet të vij deri te ["…] shpallja e zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës për të siguruar që qytetarët gëzojnë të drejtën për zgjedhje të lira dhe të barabarta në themelimin e vetëqeverisjes së tyre lokale".[39] Sikundër shihet, kompetenca **ratione materiae** e Gjykatës në këtë rast është ndërtuar mbi bazën e shpalljes së lejueshme të kërkesës së **Presidentit të Republikës**, e formuluar në formë të pyetjes që ai ia kishte drejtuar Gjykatës me qëllim interpretimin e efekteve juridike të dorëheqjes së paraqitur në publik nga ana e kryetarit të **Komunës së Rahovecit**, **Qazim Qeska**. Këtë pyetje të Presidentit, Gjykata e shndërroi si bazë për themelimin e juridiksionit të vet **ratione materiae**, duke e cilësuar dorëheqjen si një çështje kushtetuese sepse akti i tillë aktivizonte liritë dhe të drejtat kushtetuese që kishin të bënin më të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes në nivel lokal.

Objekt i kontrollit kushtetues këtu nuk ka qenë asnjë nga aktet juridike apo veprimet nga neni 113 ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] i Kushtetutës, por fakti jetësor i materializuar (shprehur) në aktin e dorëheqjes së bërë publike nga kryetari i **Komunës së Rahovecit**, **Qazim Qeska**. Objekti i kërkesës së Presidentit, ndërkaq, ishte i formuluar në formë të pyetjes lidhur me vlerësimin e efekteve juridike të dorëheqjes së bërë publike nga një kryetar komune. Këtu, në këtë rast, Gjykata ushtroi aktivizëm gjyqësor, më të gjerin në historinë e vet nga themelimi në vitin 2009, duke i hapur dyert një aktivizmi permanent gjyqësor çdoherë kur si palë do të paraqiteshin Presidenti apo Qeveria. Në këtë rast, sikundër

---

34 *Rasti K0 98/11. Aktgjykim . Parashtrues: Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Nr. ref.: AGJ 138/11. Prishtinë më 20 shtator 2011

35 *Rasti KO 57/12 . Aktgjykim. Kërkesa e Presidentes së Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së Saj, Atifete Jahjaga, me të cilën konteston votimin për miratimin e Ligjit nr. 04/1-084 "Për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.: AGJ297/12. Prishtinë, më 20 shtator 2012.

36 *Rastin K0 103/14. Aktgjykim. Parashtrues: Presidentja e Republikës së Kosovës. Përkitazi me vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 84 (14) [Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Nr. ref.: AGJ 671/14. Prishtinë, më 1 korrik 2014 .
Shkurtesa **VLAN qëndron për grupimin e partive politike që kishin humbur në zgjedhjet nacionale të qershorit 2014, por që ishin bërë bashkë dhe mendonin se si tërësi mund të përmbysnin rezultatin e zgjedhjeve dhe t'i prinin formimit të qeverisë dhe institucioneve tjera qendrore, të cilat duheshin ndërtuar pas certifikimit të këtyre zgjedhjeve. Në këtë kuptim, VLAN-i** ka të bëjë me zgjedhjen e qeverisë dhe kërkesën e partive të koalicionit **VLAN për të dhënë mandatarin për formimin e ekzekutivit kosovar, kurse VLAN II** ka të bëjë me propozimin e kryetarit të Kuvendit të Kosovës nga ana e këtij koalicioni, duke përjashtuar partinë që kishte dalë fituese e zgjedhjeve të qershorit 2014. U mor vesh, me fitore në kontekstin e sistemit zgjedhor proporcional kosovar nënkuptohet vetëm fituese relative i zgjedhjeve në raport me tjerët meqë fitues absolute të zgjedhjeve asnjëherë nuk mund të ketë në një sistem të tillë zgjedhor.

37 *Rasti KO 130/15. Aktgjykim. Parashtrues: Presidentja e Republikës së Kosovës. Lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar "Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore" me frymën e Kushtetutës, me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. Ref.: AGJ 877/15. Prishtinë, 23 dhjetor 2015.

38 *Rasti KO 80/10. Aktgjykim. Kërkesa e Presidentit të Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së tij Dr. Fatmir Sejdiu, për sqarim të kompetencave në rastin e kryetarit të Rahovecit, z. Qazim Qeska*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Ref. nr. AGJ 46110. Prishtine: më 7 Tetor 2010 . Parag. 41.

39 Pikat II & III të pjesës operative të Aktgjykimit në rastin **KO 80/10.**

shihet, cilësia e palës përcakton kompetencën **ratione materiae**, jo objekti i juridiksionit material të përcaktuar me kushtetutë dhe me ligj. Ky objekt gjendet i definuar me dispozitat e nenit 113 të Kushtetutës, paragrafi i fundit i së cilës përcakton se "[...] juridiksioni shtesë mund të caktohet me ligj". Se kur mund të shërbejë ligji si parametër për identifikimin e objektit juridiksional të Gjykatës Kushtetuese e kemi sqaruar gjetiu.[40]

Në **rastin e ushtruesit të detyrës së Presidentit të Republikës**, i dyti në vijim, Gjykata Kushtetuese sërish ka ushtruar aktivizëm gjyqësor. Këtu, megjithatë, aktivizmi gjyqësor është i dyfishtë dhe më i gjerë së në rastin pararendës. Kjo është kështu për shkak se ky rast ka përfshirë si anën procedurale ashtu edhe anën materiale të Kushtetutës.

Në aspektin procedural, gjendja ngelet e njëjtë: Gjykata përcakton kompetencën **ratione materiae** në bazë të cilësisë së palës, përkatësisht në bazë të cilësisë së ushtruesit të detyrës së **Presidentit të Republikës.** Pas dorëheqjes së ish-Presidentit të Republikës së Kosovës, **Fatmir Sejdiu**, më 27 shtator 2010, për shkak se Gjykata e kishte gjetur në shkelje të Kushtetutës me Aktgjykimin e datës 28 shtator 2010, ushtruesi i detyrës së **Presidentit të Kosovës**, **Jakup Krasniqi**, kishte ngritur pyetje kushtetuese me të cilat kërkonte nga Gjykata Kushtetuese që të sqarojë nëse ai kishte të drejtë të mbante postin e sekretarit të përgjithshëm të **Partisë Demokratike të Kosovës** (PDK) dhe funksionin e ushtruesit të detyrës së Presidentit të Kosovës. Me këtë rast, Gjykata tha se në aspektin juridiksional ushtruesi i detyrës së Presidentit kishte statusin e Presidentit të Kosovës dhe se çdoherë mund t'i drejtohej Gjykatës për konsultime (sic!).[41]

Në aspektin material, ndërkaq, gjendja qëndron më ndryshe: ky rast shënon të parin ku Gjykata shpërfaqë aktivizmi gjyqësor material. Ky lloj aktivizmi, i kësaj natyre, ka konsistuar në zgjerimin e situatave dhe rrethanave nën të cilat dikush mund të caktohej ushtrues detyre i **Presidentit të Kosovës**. Neni 90 ["Mungesa e Përkohshme e Presidentit"] të Kushtetutës përcakton dy situata dhe rrethana kur kryetari i Kuvendit të Kosovës mund të caktohej si ushtrues detyre i Presidentit për 6 (gjashtë) muaj. Situata apo rrethana e parë është kur vetë Presidenti në mënyrë vullnetare e bartë (delegon) një funksion të tillë të kryetari i Kuvendit. E dyta, ndërkaq, ekziston atëherë kur jashtë vullnetit krijohen rrethanat për një gjë të tillë. Në Kushtetutë nuk ekziston një bazë e tretë për delegim (bartje) të funksionit si më sipër. Situata apo rrethana kur mund të vijë deri te delegimi (bartja) e funksionit të Presidentit të Republikës në kryetarin e Kuvendit të Kosovës u ndërtua nga Gjykata sipas analogjisë: meqë posti i kryetarit të Kuvendit nuk është post që ngërthen funksione të njëjta më ato të kryetarit të Republikës dhe se zgjedhja e kryetarit të Kuvendit nuk është e njëjtë me zgjedhjen e Presidentit të Republikës,[42] atëherë ushtrimi i detyrës së Presidentit të Republikës nga ana e kryetarit të Kuvendit është kushtetuese çdoherë kur posti i shefit të shtetit ngelet vakant për një periudhë të pacaktuar. As në këtë rast, njëjtë si në rastin **KO 80/10**, Gjykata nuk mund të përcaktonte se cili ishte afati kohor brenda të cilit Presidenti i Republikës mund të parashtronte kërkesat nga neni 84.9 ["Kompetencat e Presidentit"] të Kushtetutës. Kjo nënkuptonte se këto lloje të kërkesave mund të parashtroheshin pa ndonjë afat kohor dhe se Gjykata Kushtetuese detyrohej çdoherë t'i shpallte të lejueshme sepse bëhej fjalë për shefin e shtetit si parashtrues i kërkesës.

Në **rastin e Imuniteteve të Deputetëve dhe të Funksionarëve të lartë shtetëror**, parashtruesi e bazonte kërkesën e vet në dispozitën e njëjtë kushtetuese me atë të nenit 84.9 të Kushtetutës. E kemi fjalën për nenin 93.10 ["Kompetencat e Qeverisë"] të Kushtetutës, i cili parashikon që Qeveria "[…] mund

---

40 Cf. seksioni 11.3.10 i kapitullit njëmbëdhjetë të librit.

41 […] 15. Ushtruesi i Detyrës se Presidentit duhet te inkurajohet te konsultohet me organin e vetëm që është në gjendje t'i shqyrtojë çështjet kushtetuese, pra me Gjykatën Kushtetuese. Për këto arsye, kjo Gjykatë konstaton që parashtruesi ka pozitë ose kompetenca që të referojë çështje para Gjykatës". *Rasti KO 97/10 . Aktgjykim në çështjen e kërkesës së parashtruar nga Ushtruesi i Detyrës së Presidentit, Dr. Jakup Krasniqi, lidhur me mbajtjen e postit të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit dhe njëkohësisht të postit të Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Demokratike të Kosovës*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës** . Prishtinë: më 22 dhjetor 2010. Nr. Ref. AGJ 78/10.

42 Cf. paragrafët 19-23 të Aktgjykimit në rastin KO 97/10.

të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese". Edhe në këtë rast, objekt i kontrollit kushtetues nuk ishte asnjëri nga aktet apo veprimet juridike të përcaktuara me nenin 113.2 & 3 ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] të Kushtetutës, nen që ua njeh pozitën e palës së privilegjuar organeve qendrore të Republikës së Kosovës. Në këtë rast, për dallim nga dy rastet e sipër cekura, njëri prej deputetëve me të drejtë kishte kontestuar cilësinë palë të ekzekutivit kosovar, duke theksuar se Qeveria nuk ka status të palës autonome jashtë situatave të përcaktuara me nenin 113. 2 & 3 të Kushtetutës dhe se, për pasojë, kërkesa e Qeverisë përbënte kërkesë për dhënien e **mendimit këshillëdhënës**, diçka që nuk ishte në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.[43]

Sa i përket të drejtës kushtetuese materiale, Gjykata këtu bëri kontrollin e kushtetutshmërisë së **Rregullores së Punës të Kuvendit** (**RPK**). Ky dokument i brendshëm i Kuvendit nuk ishte objekt i kontrollit kushtetues **për se**, por shërbeu si parametër për vlerësimin e caqeve të imunitetit të funksionarëve të lartë publik në Kosovë, në rend të parë të deputetëve, Qeverisë dhe ministrave të saj dhe Presidentit të Kosovës. Me këtë rast, Gjykata gjeti se disa dispozita të **RPK** ishin pa asnjë vlerë juridike meqë ofronin një imunitet caqet e të cilit nuk ishin të përcaktuara me Kushtetutë, përkatësisht parashikonin një imunitet jofunksional dhe i jepnin të drejtë Kuvendit që të vendoste për arrestimin dhe ndalimin e deputetit në secilën situatë jetësore. Këto dispozita të **RPK**, Gjykata nuk i shpalli si jo kushtetuese, por thjeshtë vetëm tregoj se ato ishin pa vlerë juridike meqë imuniteti i deputetëve të Kuvendit ishte në tërësi funksional dhe, për rrjedhojë, jashtë këtij imuniteti nuk kishte as nevojë që të kërkohej leja e Kuvendit për arrestim apo ndalje të deputetëve të **Kuvendit të Kosovës.**[44] Kjo leje duhej kërkuar nga Kuvendi vetëm atëherë kur bëhej fjalë për kohën sa deputeti ishte në mbledhje apo në seancat dhe takimet tjera të Kuvendit duke ushtruar detyrat e veta si deputetë të përcaktuara me nenin 65 ["Kompetencat e Kuvendit"] të Kushtetutës.

Edhe në **rastin e pensioneve të FSK-së**, Gjykata ka konstatuar dhe pranuar se pyetjet që ishin parashtruar nga Shefi i Shtetit kosovar sipas dispozitës së nenit 84.9 të Kushtetutës ishin çështje kushtetuese dhe, për pasojë, rasti quhet i lejueshëm për shqyrtim dhe vendosje, pa marrë parasysh kërkesat e nenit 113.1 të Kushtetutës që thonë të kundërtën e kësaj. Në fakt, edhe në këtë vendim Gjykata thekson se nuk ka nevojë të vlerësohet

---

43 "[…] 34. Se treti, ai theksoi nenin 113 (2) të Kushtetutës, i cili i jep kompetence Qeverise, ndër të tjera, të ngre çështjet e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe te rregulloreve te Qeveris, me Kushtetutën. Ai theksoi se Qeveria nuk kishte identifikuar asnjë çështje të përputhshmërisë me Kushtetutën, dhe prandaj, asnjë kërkesë nuk mund të parashtrohej sipas nenit 113.

35. Ai ishte i mendimit se Kushtetuta nuk lejonte parashtrimin e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese për mendime këshillëdhënëse për çështjet që kanë të bëjnë me fushëveprimin ose zbatimin e ligjit, dhe se prandaj çdo kërkesë e tillë ishte *ultra vires* Kushtetutës. Ai ishte i mendimit se kërkesa e parashtruar sipas nenit 93 (10) të Kushtetutës u nënshtrohej dispozitave të nenit 113 të Kushtetutës dhe se Qeveria nuk kishte qasje te posaçme në Gjykatë jashtë nenit 113 të Kushtetutës." *Rasti KO 98/11. Aktgjykim . Parashtrues: Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Nr. ref.: AGJ 138/11. Prishtinë më 20 shtator 2011.

44 "[…] 68. Kushtetuta nuk lejon kufizim ose ndërhyrje nga legjislativi në ndjekjen penale të deputetëve të Kuvendit për veprimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre.

69. Pasi Kushtetuta nuk garanton paprekshmëri lidhur me ndjekjen penale të deputetëve të Kuvendit për veprimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre, ata nuk janë të paprekshëm as lidhur me ndjekjen penale për veprat penale të cilat pretendohen të jenë kryer para fillimit të mandatit të tyre si deputetë ose gjatë rrjedhës së mandatit të tyre.

70. Neni 22 (3) i Rregullores së punës së Kuvendit përcakton që "Deputeti gëzon imunitet ndaj ... ndjekjes penale, përderisa Kuvendi nuk merr vendim për heqjen e imunitetit te tij". Gjykata Kushtetuese vëren që kjo dispozitë, lidhur me ndjekjen penale, është pa vlerë juridike pasi në Kushtetutë nuk ka imunitet të tillë ndaj ndjekjes penale të deputetit. Gjykata përsërit edhe një herë se nuk ekziston imunitet që e pengon ndjekjen penale të deputetëve për veprimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre. Nuk nevojitet vendimi i Kuvendit për një ndjekje të tillë penale.

71. Rrethana e vetme kur kërkohet vendimi i Kuvendit për heqjen e imunitetit ka të bëjë me arrestimin ose ndalimin e deputetit kur ai/ajo është duke kryer detyrat e tij/saj si deputet. Ky është qëndrim kushtetues". *Rasti KO 98/11.*

plotësimi i kushteve nga neni 113.1 i Kushtetutës sepse kërkesa është **ipso iure** e lejueshme për faktin se është paraqitur nga personi i autorizuar, **Presidenti i Republikës**, sipas nenit 84.9 të Kushtetutës.[45] Ky nen, ndërkaq, nuk saktëson se çka mund të jetë objekt i kontrollit kushtetues: leximi i nenit 84.9 të Kushtetutës mund kuptohet vetëm brenda përcaktimeve të nenit 113.1 & 2 të Kushtetutës. Asnjëherë ndryshe! Në thelb, leximi i saktë i dispozitës së nenit 84.9 është i plotë vetëm nëse shtohet edhe fjalia "në pajtim me këtë Kushtetutë". E njëjta vlen, **mutatis mutandis**, edhe për ekzekutivin kosovar, përkatësisht për nenin 93.10 të Kushtetutës.

Është shumë me rëndësi të theksohet se ky rast është shpallur i lejueshëm pikërisht si pasojë e cilësisë së palës së autorizuar nga neni 84.9 të Kushtetutës, përkundër faktit se objekt efektiv dhe real i kontrollit kushtetues nga ana Gjykatës ka qenë vendimi i Kuvendit të Kosovës me të cilin është hedhur poshtë kërkesa e Presidentes së Republikës, **Atifete Jahjaga**, për amendamentimin e Ligjit nr. 04/L-084 për Pensionet e Pjesëtarëve të FSK ("Forcën e Sigurisë së Kosovës"). Kjo qasje e Gjykatës është kushtëzuar nga fakti se vetë Presidentja Jahjaga ka formuluar kërkesën e saj në formë të pyetjeve kushtetuese, duke anashkaluar aktin juridik, vendimin e Kuvendit të Kosovës, i cili është dashur të jetë objekt i kontrollit kushtetues.[46] Jo vetëm kaq! Edhe në këtë rast, Gjykata ka diskutuar për **RPK**, duke e marrë si parametër për vlerësimin nëse parashtrueses së pyetjeve kushtetuese, ish-Presidentes **Atifete Jahjaga**, iu ishte shkelur e drejta e vetos suspensive. Në këtë rast, megjithatë, për dallim nga rasti i parë, Gjykata ka përdorur **RPK** në mënyrë afirmative për të konstatuar se rregullat e brendshme juridike të jetës parlamentare kosovare konfirmonin të drejtën e vetos suspenzive të Presidentit të Republikës, por jo edhe të drejtën për të propozuar amendamentime shtesë në ligjin e miratuar nga Kuvendi.[47]

Kjo tregon për tendencën e Gjykatës për të anashkaluar pushtetet nga neni 113.1 & 2 të Kushtetutës çdoherë kur si palë kërkuese paraqitej shefi i shtetit ose ekzekutivi i Kosovës. Me kalimin e kohës, kjo tendencë ka marrë qytetarinë në punën e **Gjykatës Kushtetuese** duke u bërë një standard përcaktues i këtij lloji të juridiksionit kushtetues. Se kjo është kështu shihet nga arsyetimi i aktvendimit për papranueshmëri në një rast që fare nuk kishte të bënte me këtë standard: në rastin **KO 18/14**, Gjykata ripërsëriti se

---

45 "[…] 33. Pyetjet e shtruara janë pyetje kushtetuese siç përcakton neni 84(9) i Kushtetutës. Prandaj nuk është e nevojshme të shqyrtohet Kërkesa në kontekst të nenit 113.1 të Kushtetutës." *Rasti KO 57/12 . Aktgjykim. Kërkesa e Presidentes së Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së Saj, Atifete Jahjaga, me të cilën konteston votimin për miratimin e Ligjit nr. 04/1-084 "Për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.: AGJ297/12. Prishtinë, më 20 shtator 2012.

46 "[...] **Objekti i çështjes:**
"[…] 8. Presidentja e Republikës së Kosovës "konteston kushtetutshmërinë e votimit për miratimin e Ligjit nr. 04/L-0B4 për "Pensionet e Pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës" dhe ktheu për shqyrtim në Kuvendin e Kosovës me Vendimin e Presidentes së Republikës së Kosovës.
9. Rrjedhimisht, Presidentja e Republikës së Kosovës i drejtohet Gjykatës për të shqyrtuar nëse ka pasur shkelje të Kushtetutës, respektivisht të nenit 80. 4, gjatë votimit në Kuvend lidhur me Vendimin e Presidentes për kthimin e Ligjit për shqyrtim.
10. Sipas Presidentes së Republikës, çështjet për shqyrtim para Gjykatës Kushtetuese janë:
"A është cenuar neni 80, paragrafi (4), i Kushtetutës së Republikës së Kosovës gjatë votimit/aprovimit të Ligjit Nr. 04/L084 "Për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës" të rikthyer për rishqyrtim Kuvendit të Kosovës me Vendim të Presidentes së Republikës së Kosovës dhe rrjedhimisht a është cenuar kompetenca e Presidentit për kthim të ligjit në rishqyrtim e paraparë me nenin 84 paragrafi 6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës?" Rasti **KO 57/12.**

47 "[…] 62. Gjykata është e vetëdijshme se neni 79 i Kushtetutës përshkruan se Presidenti mund të marrë nismën për të propozuar ligje nga fushë veprimtaria e tij/saj.
63. Ajo dispozitë e Kushtetutës është elaboruar më tej në nenin 53.1 të Rregullores së Punës se Kuvendit të Kosovës që thotë:
"Propozim të Projektligjit në Kuvend mund ta paraqesë Presidenti i Republikës se Kosovës, nga fusha e veprimtarisë së tij ..."
64. Rregullorja e Punës së Kuvendit më tej elaboron në nenin 54 kushtet për të paraqitur një Projekt-Ligj, siç është notë sqarimi, deklarimi i implikimeve buxhetore, etj.
65. Sidoqoftë, Presidenti i Republikës në rastin konkret nuk ka ushtruar të drejtën sipas nenin 79 te Kushtetutës dhe siç elaborohet më tutje në nenin 53. 1 dhe 54 të Rregullores së Punës së Kuvendit për të paraqitur Ligjin dhe /ose amendamentet në Kuvend".

rasti do të ishte i lejueshëm çdoherë kur si palë kërkuese në procedurat pranë saj do të paraqiteshin Presidenti dhe Qeveria në bazë të neneve respektivisht 84.9 dhe 93.10 të Kushtetutës.[48]

Edhe në **rastin VLAN I**, Gjykata Kushtetuese ka konfirmuar se ka juridiksion për të vendosur rreth kërkesave të shefit të shtetit kur ato kanë për objekt, thjeshtë, kërkesën për vlerësimin e "kushtetutshmërisë" së normave kushtetuese duke i krahasuar ato njëra me tjetrën, jo kontrollin kushtetues të një akti juridik në kuptim të nenit 113.2 & 3 të Kushtetutës.[49] Për aspektet tjera të rastit **VLAN** diskutojmë në kapitullin e fundit.[50]

Në **rastin Asociacionit Serb**, për dallim nga rastet e mëparshme, lejueshmëria e kërkesës së Presidentes së Republikës, **Atifete Jahjaga**, bazohet në nenin 84.9 lidhur me nenin 112.1 të Kushtetutës, pra jo në nenin 84.9 lidhur me nenin 113. 2 & 3 të Kushtetutës.[51] Kjo bazë mbështetëse për ushtrim të juridiksionit është edhe më e çuditshme (sic!). Të shohim në vijim se si duket kjo, ani se kësaj çështje i kthehemi sërish në kapitullin e gjashtëmbëdhjejtë, por nga një kënd tjetër.[52] Sipas Gjykatës, kërkesa e Presidentes **Atifete Jahjaga** në këtë rast ngrit çështje të natyrës kushtetuese sepse fjala është për një marrëveshje që prek formën e qeverisjes së shtetit, të cilën, në mënyrë krejt të gabuar, e definon "[...] *inter alia*, në ndarjen e tij në vetëqeverisje lokale dhe qendrore".[53] Kjo d.m.th. se Gjykata në mënyrë të gabuar **ndarjen vertikale të pushteteve** e cilëson si formë të qeverisjes së shtetit (sic!).

Të vazhdojmë tani diskutimin me aktivizmin gjyqësor në rastet kur si parametër për vlerësim të **kontrollit të kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese** shërbejnë kriteret **ekstra- kushtetuese** apo **ekstra-juridike** dhe që nuk figurojnë në tekstin kushtetues **ratione materiae**. Në fakt, në këtë rast rrallë herë mund të bëhet fjalë për aktivizëm gjyqësor sepse bëhet fjalë për **ndryshim rrënjësor të identitetit kushtetues të shtetit**, përkatësisht të shoqërisë përkatëse marrë si tërësi. Në situata të tilla, kontrolli kushtetues bazohet në mekanizma të ri kushtetues, përkatësisht në dizajnin e ri institucional në pikëpamje të juridiksionit, përmbajtësisht i ndryshëm nga pararendësi i vet dhe me bazë në kushtetutën e re që interpretohet sipas këtij dizajni institucional.

---

48 "[...] 20. Gjykata rithekson se, sipas nenit 93 (10) [Kompetencat e Qeverisë] të Kushtetutës, *"Qeveria ka këto kompetenca: mund te referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese".*
Për më tepër, në rastin Nr. K098/11, Gjykata gjeti se *"Sipas nenit 93 (10) te Kushtetutës, Qeveria mund te referoje çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese. Nëse çështjet janë çështje kushtetuese, atëherë Qeveria do të jetë palë e autorizuar dhe kërkesa do të jetë e pranueshme"* (Shih rastin **KO 98/11**, Parashtruesi: Qeveria e Republikës së Kosovës, Aktgjykimi i 20 shtatorit 2011).
21. Për më tepër, Gjykata po ashtu rithekson se, në bazë të nenit 84 (9) [Kompetencat e Presidentit] të Kushtetutës, *"Presidenti i Republikës* së *Kosovës mund të referoje çështje kushtetuese* në *Gjykatën Kushtetuese".*
22. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se kompetencat e organeve shtetërore kushtetuese duhet të ushtrohen sipas dispozitave të Kushtetutës." *Rasti KO 18/14. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Vesna Mikiq dhe 20 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kërkesë për "[...] interpretim të dispozitave të Kushtetutës se Kosovës lidhur me vendet e rezervuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosove"*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.: RK 551/14. Prishtinë, më 11 shkurt 2014.

49 "[…] 64. Objekti i kërkesës së tanishme, në të vërtetë, ka të bëjë me kompetencat e Presidentit të Republikës, si kreu i shtetit dhe në përfaqësim të unitetit të popullit te Republikës së Kosovës, për të caktuar mandatarin për formimin e Qeverisë, në përputhje me procedurën që duhet ndjekur për formimin e qeverisë pas zgjedhjeve të përgjithshme. *Rasti KO 103/14. Aktgjykim. Parashtrues: Presidentja e Republikës së Kosovës. Përkitazi me vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 84 (14) [Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Nr. ref.: AGJ 671/14. Prishtinë, më 1 korrik 2014. ". Cf. edhe paragrafët si vijon: 53, 57, 58, 61-62.

50 Cf. seksioni 16.5 i kapitullit të gjashtëmbëdhjetë

51 **Rasti KO 103/14**.,paragrafet: 180-109; 189. 1& 2.

52 Cf. seksioni 16.7 i kapitullit të gjashtëmbëdhjetë.

53 **Rasti KO 103/14:** "[…] 107. Në një mënyre analoge, Gjykata konsideron se efektet juridike në institucione, të parapara me Marrëveshjen e Parë, kanë të bëjnë me formën e qeverisjes së shtetit, *inter alia,* në ndarjen e tij në vetëqeverisje lokale dhe qendrore. Përveç kësaj, pasojat juridike lidhur me implementimin e kësaj pjese të Marrëveshjes së Parë kanë ndikim në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, mënyra se si zbatohet Marrëveshja e Parë ka implikime për funksionimin demokratik të shtetit."

Me këtë rezervë parasysh, në vijim pason diskutimi i praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht diskutimi lidhur me rastet në të cilat ka ardhur në shprehje përdorimi i argumenteve **ekstra-juridike** dhe **ekstra-kushtetuese**, ani se nuk ka qenë fjala për ndryshim rrënjësor të identitetit kushtetues kosovar. Në fakt, siç do të shihet në vijim, këtu nuk bëhet fjalë për asnjë ndryshim në identitetin kushtetues të Kosovës. Siç u konstatua më sipër, në Kosovë akoma nuk ka pasur rast të kontrollit kushtetues të ushtrimit të pushtetit konstituiv origjiner. Së paku jo deri në momentin e shkrimit të këtyre rreshtave (mars 2017).

Vendimi i parë që përmend në arsyetimin e vet argumentet **extra-kushtetuese** dhe **ekstra-juridike** është aktgjykimi i dhënë në rastin e **Logos të Komunës së Prizrenit**, i njohur ndryshe edhe si rasti i **Logos së Prizrenit.**[54] Si rast tjetër që vlen të përmendet është edhe rasti i **Ligjit për Hoçën e Madhe dhe Qendrën Historike të Prizrenit**.[55]

Ngjashëm me këto raste janë edhe vendimet e **Gjykatës Kushtetuese** në të cilat është përdorur argumenti i **shkronjës dhe frymës së Kushtetutës**. Pikë referimi për të shërbyer si parametër në rastet e këtij argumentimi ka qenë dhe ngelet interpretimi i dhënë nga Gjykata Kushtetuese. Thënë me fjalë të tjera, se çka nënkuptohet me **shkronjën dhe frymën e Kushtetutës** përcaktohet jo sipas parametrave të tekstit kushtetues por sipas interpretimit të dhënë nga **Gjykata Kushtetuese** lidhur me vendndodhjen e frymës dhe shpirtit të Kushtetutës në secilin rast apo mosmarrëveshje konkrete të vendosur nga ajo. Në këtë grup të vendimeve hyjnë si vijon: rasti i **ish-Presidentes Atifete Jahjaga**;[56] rasti i kontrollit kushtetues të **amendamenteve për përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur;**[57]

---

54 "[…] 43. Prizreni gjendet në jug të Kosovës dhe për shkak të pozitës së tij gjeografike është qendër e rëndësishme komerciale dhe afariste. Ai ka histori të gjatë dhe traditë të larmisë etnike. Është i pasur në kultura, e aq më shumë për shkak të larmisë dhe heterogjenitetit etnik të popullsisë së tij. Prizreni ka traditë të gjatë të bashkëpunimit dhe tolerancës mes komuniteteve të tij të ndryshëm. Komuna e Prizrenit ka anëtarë nga komunitetet e ndryshme, si dhe parashtruesi, Z. Kurtishi, është Zëvendës Kryesues për Komunitete i Komunës.
44. Ankesa e veçantë në këtë rast ka të bëjë me simbolin e Komunës së Prizrenit. Simbolet janë afërsisht të lidhura me nxitjen dhe ruajtjen e traditës, kulturës, karakteristikave të veçanta të secilit komb, si dhe kanë ndikimin në grumbullimin dhe bashkimin rreth një ideje dhe një besimi. Nuk ka kurrfarë dyshimi që simbolet përçojnë disa emocione dhe kuptime, të cilat përjetohen në mënyra të veçanta nga ata që gjejnë historinë, traditën dhe kulturën e tyre në ato simbole. Simbolet nuk janë fotografi e dekorime të pastra, por secili përmban një kuptim të caktuar më të thellë dhe të fshehtë". *Rasti KO 01/09. Aktgjykim . Qemajl Kurtishi dhe Kuvendi Komunal i Prizrenit.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë. Datë: 18 mars 2010. Ref. Nr. AGJ 07/10.

55 "[…] 47. Kosova është pjesë e lashtë e Evropës dhe ka trashëgimi të pasur kulturore parahistorike dhe historike. Rajoni që përbën Kosovën, siç ishte rasti me shumë pjesë të Evropës, e posaçërisht me Ballkanin, ishte ndikuar nga perandoritë dhe civilizimet e kohëve më të hershme. Njerëz të ndryshëm kanë jetuar këtu dhe i kanë lënë trashëgimitë e veta kulturore gjatë shekujve të kaluar. Kështu që Kosova sot është përzierje e historisë së vet dhe e popujve të vet, dhe ky diversitet dhe shumetnicitet pasqyrohet në gjashtë yjet e flamurit të Republikës së Kosovës.
48. Të gjitha bashkësitë i kanë kulturat dhe trashëgiminë e veta të ndryshme dhe Kushtetuta i njeh këto diversitete dhe ofron një strukture për ruajtjen e asaj kulture dhe trashëgimie. Kjo bëhet jo vetëm për të mirën e një bashkësie individuale, por për të mirën e çdokujt në shtet." *Rastet K0 45/12 dhe K0 46/12. Aktgjykim. Kërkesa e Liburn Aliut dhe 11 deputetëve të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe dhe të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës** . Prishtine, më 25 qershor 2012 . Nr.Ref.:AGJ 255/12.

56 "[..] 64 Prandaj, me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së amendamenteve të propozuara, kjo Gjykatë nuk do t'i marrë parasysh vetëm të drejtat dhe liritë e njeriut të përfshira në Kapitullin II, por edhe të gjitha të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe të parashikuara me shkronjën dhe frymën e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës*." Rastet K.O. 29/12 dhe K.O. 48/12. Aktgjykim. Amendamentet e propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtine, me 20 korrik 2012 Nr. Ref.:AGJ 284.

57 " […] 30. T'i kthehemi Kapitullit II, Gjykata vëren që në përputhje me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit II, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës. Përveç kësaj, sipas nenit 21.2, Republikës së Kosovës i takon t'i mbrojë dhe garantojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të parashikuara në këtë Kushtetutë.
31. Prandaj, Gjykata konsideron që neni 21 përcakton shtrirjen e Kapitullit II për t'i përfshirë edhe ato të drejta dhe liri themelore të njeriut të përcaktuara gjetiu në Kushtetutë. Rezulton që Gjykata duhet të vlerësojë nëse amendamentet e propozuara pakësojnë ndonjë të drejtë dhe liritë e garantuara me Kushtetute si tërësi". *Rasti K0 38/12. Aktgjykim. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Propozimeve të Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës, të dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës më 12 prill 2012* . **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtinë, më 15 maj 2012. Nr. ref.:AK 234 /12.

rasti i **Ligjit për Amnisti**;[58] rasti i amendamenteve për themelimin e **FARK** (**Forcave të Armatosura të Kosovës/Ushtrisë së Kosovës);**[59] rasti i **amendamenteve për barazinë gjinore në ekzekutiv**;[60] rasti i **amendamentit për themelimin e Gjykatës Speciale**;[61] dhe rasti i **Asociacionit Serb**, si më sipër.[62] Vlen të theksohet këtu se në të gjitha këto raste bëhet fjalë për argumentet e Gjykatës Kushtetuese të dhëna në pjesën arsyetuese, për të mbështetur verdiktin e saj përfundimtar, duke u shërbyer me qasje aktiviste që nuk ndalon në parametrat kushtetues të Kapitullit II ["Të Drejtat dhe Liritë Themelore"] të Kushtetutës. Kjo qasje argumentative është në funksion të interpretimit të gjerë të Kushtetutës, brenda parametrave që përfshijnë çdo germë të saj. Kjo ka të bëjë vetëm me vlerësimin e amendamenteve kushtetuese, përkatësisht me vlerësimin e kushtetutshmërisë së ushtrimit nga ana e përfaqësuesit të sovranit të **pushtetit konstituiv derivativ**. Deri më sot nuk ka pasur asnjë amendament që do të përbënte tentim për ushtrim të **pushtetit konstitutiv origjiner**, përkatësisht ushtrim të pushtetit konstitutiv origjiner që deformon ose ndryshon identitetin kushtetues të Kosovës.

Edhe në përvojën e vendeve të tjera, si parametër matës për gjykim nëse një gjykatë kushtetuese apo gjykatë tjetër ekuivalente me te është aktiviste në sferën e kontrollit abstrakt të normave kushtetuese shërbejnë dispozitat kushtetuese (krahas parametrave tjerë ekstra-kushtetues që mund të hyjnë në punë). Këtë e konstatuam më sipër, kur treguam se këta parametra mbulojnë vetëm kontrollin kushtetues të ushtrimit të **pushtetit konstitutiv derivativ**, nisur nga fakti se te ushtrimi i **pushtetit konstitutiv origjiner** mund të vijë deri të **revidimi rrënjësor kushtetues** dhe, për pasojë, deri te ndryshimi me rrënjë i identitetit ekzistues kushtetues. Pikërisht për këtë arsye, te rasti i ushtrimit të **pushtetit konstitutiv origjiner**, përveç dispozitave ekzistuese kushtetuese, në disa raste si parametër shërbejnë edhe disa kritere të tjera **ekstra-kushtetuese** dhe **ekstra-juridike**, jashtë atyre që gjenden në tekstin kushtetues dhe në interpretimet e

---

58 "[…] 18. Konfirmimi i kushtetutshmërisë së amendamenteve të propozuara nuk do të bëhet nga ana e kësaj Gjykate, duke marrë parasysh vetëm të drejtat dhe liritë e njeriut që përfshihen në Kapitullin II, por edhe gjithë shkronjën dhe frymën e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës, siç sqarohet më tepër në paragrafët 56 deri 71 të Aktgjykimit të nxjerrë në rastet K029/12 dhe K048/12 (amendamentet e propozuara të Kushtetutës nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 23 mars 2012, gjegjësisht me 4 maj 2012) të 20 korrikut 2012. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës." *Rasti K0 61/12. Aktgjykim. Konfirmimi i amendamenteve te propozuara kushtetuese, të paraqitura nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 22 qershor 2012, me shkresën Nr. 04-DO-1095* . Gjykata **Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtine, më 31 tetor 2012 . Nr. ref.: AGJ303/12. Një redaktim tërësisht të njëjtë e ka edhe Aktgjykimi në rastin KO 09/13 i datës 29 janar 2013 (Nr. Ref.: AGJ 367/13), në paragrafin 17 që bën fjalë për shtrirjen e konfirmimit kushtetues që e bën Gjykata Kushtetuese në rastet të tilla.

59 "[…] 28. Prandaj, me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së amendamenteve të propozuara, kjo Gjykate nuk do t'i marrë parasysh vetëm të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të përfshira në Kapitullin II, por tërë shkronjën dhe frymën e Kushtetutës (Shih Rastin Nr. K029/12 dhe K048/12, Parashtrues: Kryetari i Kuvendit te Republikës se Kosovës, Aktgjykim i 20 korrikut 2012).". *Rasti K0 44/14. Aktgjykim. Vlerësimi i amendamenteve të Kushtetutës të propozuara nga Qeveria, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 11mars 2014, me shkresën Nr. 04-DO-2186.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 3 prill 2014. Nr.ref.:AGJS98/14.

60 " […] 23. Fushëveprimi i vlerësimit të amendamentit të propozuar bazohet në Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore], në Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] dhe në shkronjën e frymën e Kushtetutës (Shih rastet nr. K029j12 dhe K048/12, parashtrues i kërkesës: *Kryetari i Kuvendit i Republikës së Kosovës,* Aktgjykim i 20 korrikut 2012; shih, gjithashtu Rastin nr. K061j12, parashtrues i kërkesës: *Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,* Aktgjykim i 31 tetorit 2012)." *Rasti K0 13/15. Aktgjykim . Vlerësim i një amendamenti të Kushtetutës së Republikës se Kosovës, të propozuar nga pesëdhjetë e pesë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe të referuar nga Kryetari i Kuvendit te Republikës së Kosovës më 6 shkurt 2015 me shkresën nr. 05-259/D0-179.* Gjykata **Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtine, me 16 mars 2015 . Nr. ref.: AGJ 782/ 15.

61 " […] 22. Fushëveprimi i vlerësimit të amendamentit të propozuar bazohet në Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore], në Kapitullin **III** [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] dhe në shkronjën e frymën e Kushtetutës (Shih rastet K029/12 dhe K048/12, parashtrues i kërkesës *Kryetari i Kuvendit të Republikës* së *Kosovës,* Aktgjykim i 20 korrikut 2012; dhe shih, gjithashtu, Rastin nr. K061/12, parashtrues i kërkesës *Kryetari i Kuvendit të Republikës* së *Kosovës,* Aktgjykim i 31 tetorit 2012)." *Rasti K0 26/15. Vlerësim i amendamentit të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe referuar më 9 mars 2015 nga Kryetari i Kuvendit te Republikës së Kosovës, me Shkresën nr. 05-433jDO-318.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 15prill 2015. Nr. ref.: AGJ 788/15.

62 *Rasti KO 130/15*: "[...] III. TË KONSTATOJË që Parimet, siç janë elaboruar në "Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore", nuk janë tërësisht në përputhshmëri me frymën e Kushtetutës, me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës". Cf. po ashtu edhe fusnotën nr. 37, **supra,** dhe tekstin që e shoqëron.

dhëna nga gjykatat kushtetuese, siç janë: ideologjia e caktuar, ngjarjet nga e kaluara historike e një populli, nevojat konkrete momentale të shoqërisë për transformim politik, gjendja e jashtëzakonshme që duhet të tejkalohet përmes ndryshimeve kushtetuese që kanë ndërprerje radikale me të kaluarën etj. etj. Si shembuj të përshtatshëm të këtyre situatave më së miri shërbejnë rastet e pavarësimit (krijimit) të ish-republikave **jugosllave** dhe ish-republikave **sovjetike** përgjatë viteve '90 të shekullit të kaluar: secila nga to u detyruan ta shpallin pavarësinë dhe të nxjerrin kushtetutat e tyre të reja mbi bazën e kritereve që nuk mbështeteshin në dispozitat e kushtetutave pararendëse, përveç bazës formale juridik-kushtetuese për nxjerrjen e tyre.[63]

Parametrat matës për kontrollin kushtetues abstrakt të normave kushtetuese ndryshojnë nga vendi në vend: në **Francë**, të tilla janë të a.q **bloc de constitutionalite**, të cilat përfshijnë dokumentet që nga koha e Revolucionit Francez (Deklarata e vitit 1789 mbi të Drejtat e Njeriut dhe të Qytetarit), Preambulën e Kushtetutës së vitit 1946 dhe dokumentet tjera më të reja (p.sh. nenet përkatëse të Kushtetutës së vitit 1958, parimet themelore të njohura nga ligjet republikane etj);[64] në **Gjermani**, sipas nenit 79.3 të **Ligjit Themelor**, cilësi të tilla kanë dispozitat kushtetuese që normojnë rregullimin federativ, pjesëmarrjen e **land**-eve në aktivitetin legjislativ, dinjiteti i njeriut, liritë dhe të drejtat e njeriut, shteti demokratik dhe shteti social dhe e drejta për rezistencë kundër ndryshimit të kësaj forme shtetërore;[65] në **Indi**, të tilla janë ato që kanë të bëjnë me laicitetin dhe shtetin federal;[66] në **Turqi**, forma republikane e qeverisjes dhe shteti laik (pas ardhjes së **Rexhep Tayp Erdogan** në pushtet, këto parametra kanë ndryshuar ashtu që sot fare lehtë merret një vendim nga **Gjykata Kushtetuese e Turqisë** që hyjnizon dhe e shpall Islamin si fe dhe ideologji zyrtare);[67] në vendet islamike, siç kemi theksuar në kapitujt e mëhershëm,[68] si parametër themelor për vlerësim nuk shërbejnë dispozitat e kushtetutës ekzistuese por e drejta e **Sheriatit** me **Kuranin** si shtyllë bazike dhe përjashtues i çdo parametri tjetër që bie ndesh me të etj. etj.[69]

Në literaturë është konstatuar se në vendet e **Amerikës Latine** paraqitet si kontroverse dhe jo uniforme teoria dhe praktika e amendamenteve kushtetuese jokushtetuese, si një ndalesë formale dhe substanciale

---

63 Në ndërkohë që në ish-**Bashkimin Sovjetik** nuk ka ekzistuar një gjyqësi kushtetuese për të vlerësuar kushtetutshmërisë e deklaratave për pavarësi të nxjerra nga ish-republikat sovjetike, si dhe të kushtetutave të tyre të reja që kryesisht përmblidheshin në amendamente kushtetuese, në rastin ish-jugosllav ka pasur një përpjekje nga niveli federal I gjyqësisë kushtetuese për të stopuar në emër të ruajtjes së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë pavarësimin dhe sovranizmin e ish-republikave jugosllave. Më një arsyetim jashtëzakonisht dogmatik dhe të ideologjizuar deri në fund, bazuar në vlerat e sistemit komunist federal që po shpërbëhej, gjyqtarët e **Gjykatës Kushtetuese të RSFJ** kishin shpallur si jokushtetuese deklaratat për shpalljen e pavarësisë së republikave veriore të ish-Jugosllavisë (Kroacia dhe Sllovenia), si dhe të amendamenteve kushtetuese të republikave tjera, përveç **Serbisë** dhe **Malit të Zi** që pretendonin se po ruanin ish-**Jugosllavinë** nga shpërbërja, të cilat ishin nxjerrë për të fituar më shumë pavarësi nga qeveria federale që me dhunë po synonte ruajtjen e Jugosllavisë. Cf. më shumë për këtë, si dhe për vendimet e **Gjykatës Kushtetuese të RSFJ** për çështjet si më sipër, në përmbledhjen me komente dogmatike të vendimeve të asaj gjykate në Milovan Buzandzic, *Secesija bivsih jugoslovenskih republika u svetlosti odluka Ustavnog suda Jugoslavije*. *Zbirka dokumenata s uvodnom raspravom* (Sluzbeni List SRJ: Beograd, 1994) (vetëm në alfabetin cirilik).

64 Louis Favoreu et al. (eds.), *Droit constitutionnel* (Dalloz: Paris, 2016) fq. 133-140.

65 Serkan Köybaşı, "Amending the Unamendable: The Case of Article 20 of the German Basic law". Në Richard Albert, Bertil Emr Oder (eds.), *An Unamendable Constitution? Unamendability in Constitutional Democracies* (Springer International Publishing: Switzerland), fq. 259-280.

66 Chintan Chandrachud, "Constitutional Falsehoods: The Fourth Judges Case and the Basic Structure Doctrine in India". Në Richard Albert, Bertil Emrah Oder (eds.), *An Unamendable Constitution? Unamendability in Constitutional Democracies*, fq. 149-168.

67 Oya Yegen, "Debating Unamendability: Deadlock in Turkey's Constitution-Making Process". Në Richard Albert, Bertil Emrah Oder (eds.), *An Unamendable Constitution? Unamendability in Constitutional Democracies*, fq. 281-311 & Tarik Olcay, "The Unamendability of Amendable Clauses: The Case of the Turkish Constitution". Në Në Richard Albert, Bertil Emrah Oder (eds.), *An Unamendable Constitution? Unamendability in Constitutional Democracies*, fq. 313-343.

68 Cf. seksioni 8.1 i kapitullit të tetë.

69 Shih më shumë për parametrat që shërbejnë si përcaktues të aktivizmit gjyqësor në këtë sferë, përfshirë këtu vendet islamike dhe qëndrimet e tyre lidhur me dispozitat e paamendamentueshme, në disertacionin e shkëlqyer të doktoratës të Kemal Gözler, *Le pouvoir de révision constitutionnelle,* Thèse pour le doctorat en droit, Directeur de recherches: Prof. Dmitri Georges Lavroff, Université Montesquieu - Bordeaux IV, Faculté de droit, des sciences sociales et politiques, 1995, fq. 774 (pjesa e parë që flet për kufijtë e revidimit kushtetues të përcaktuar me kushtetutë dhe kufijtë e revidimit kushtetues që kanë lindur në mënyrë jokushtetuese dhe nga praktika gjyqësore si pasojë e nativizmit gjyqësor të gjykatave kushtetuese).

(materiale) për zhvillim të aktivizmit gjyqësor në sferën e ushtrimit të **pushtetit konstituiv origjiner**.[70] E njëjtë paraqitet edhe gjatë secilës valë të përhapjes së gjyqësisë kushtetuese, valë që janë shoqëruar me debat të gjallë lidhur me **amendamentet e pandryshueshme kushtetuese** dhe rolin e tyre në pengimin e aktivizmit gjyqësor në sferën e ushtrimit të **pushtetit konstitutiv origjiner**. Në të gjitha rastet e ekzistimit të kësaj teorie dhe praktike, që janë thuajse pa fund gjithandej, kushtetutat ose praktika gjyqësore i vë disa kufij substancial (material) dhe formal me qëllim të pengimit të ndryshimit të identitetit fillestar kushtetues, duke vënë qartë vijën e kuqe në mes të parametrave të lejueshëm për t'u përdorur në procesin e amendamentimit kushtetues dhe atyre që nuk kanë një forcë të tillë ndaluese.[71]

Në të gjitha rastet e kontrollit abstrakt të amendamenteve kushtetuese fjala është për ruajtjen e kufirit në mes të **kushtetutës së gjallë** dhe **kushtetutës së vdekur**. Këtë frazeologji e ka përdorur për herë të parë **Thomas Jefferson**, kur ka thënë se kushtetuta nuk është për të vdekurit, por për të gjallët.[72] Kjo ka kuptimin e asaj që me kalimin e kohës lindë nevoja për ndryshime tekstuale kushtetuese ashtu që gjykata kushtetuese e shndërron një dokument të vdekur në kuptimin jefersonian në një dokument të gjallë, duke ia përshtatur tekstin nevojave të kohës.

Ideja e kushtetutës si **dokument i gjallë** ka histori të gjatë në diskursin nacional amerikan, ku edhe ka lindur.[73] Në këtë sistem, teoria dhe praktika e **kushtetutë së gjallë** bazohet në idenë e ikjes nga amendamentimi kushtetues, përmes përshtatjes së tekstit të kushtetutës rrethanave aktuale. Kjo bëhet përmes interpretimit aktivist që bazohet kryesisht në mbështetjen në të **drejtën e përgjithshme**. Kjo mbështetje ua mundëson gjyqtarëve që me rastin e interpretimit të shërbehen me precedentët nga e kaluara dhe në arsye konkrete pragmatike, duke anashkaluar nevojën për t'u mbështetur në historinë jolegale të hartimit të tekstit kushtetues (siç është, ta zëmë, analizimi i rolit të personaliteteve të caktuara në hartimin e kushtetutës, roli i rrethanave historike dhe revolucionare të lindjes së një kushtetute, dhe kështu me radhë). E kundërta e kësaj është **teknika origjinaliste e interpretimit**, që kërkon çdoherë vlerësimin e qëllimit origjinal të gjeneratës së hartuesve të kushtetutës dhe tërë historinë që ka çuar në përpilimin e tekstit fillestar kushtetues.[74] Në diskursin kushtetues amerikan, pra, ekzistojnë vetëm dy teknika dhe dy filozofi kundërthënëse të interpretimit, **origjinalizmi** dhe **kushtetuta e gjallë.**[75]

---

70 Juliano Zaiden Benvindo, "Brazil in the Context of the Debate Over Unamendability in Latin America", fq. 345-364.

71 Për rezultatet e hulumtimeve të të tri valëve të përhapjes së gjyqësisë kushtetuese dhe evidentimit të pengesave për amendamentimet formale apo substanciale që cenojnë ose shkatërrojnë identitetin kushtetues fillesatr, shih më shumë në Valentina Rita Scotti, "Unamendable Constitutional Provisions and the European Common Constitutional Heritage: A Comparison Among Three Waves of Constitutionalism". Në Richard Albert, Bertil Emrah Oder (eds.), *An Unamendable Constitution? Unamendability in Constitutional Democracies*, fq. 365-390.

72 Cf. më shumë për këtë debat, i njohur ndryshe edhe si debati në mes të origjinalistve dhe konstitucionlistëve të gjallë, në Timothy Brennan, "Thomas Jefferson and the Living Constitution" . *The Journal of Politics* Vol. 79 No. 3 (July 2017) fq. 936-948.

73 Paul L. McKaskle, "The European Court of Human Rights: What It Is, How It Works, and Its Future". *University of San Francisco law Review* Volume 40 Issue 1 (Fall 2005) fq. 8-84 në fq.52-55.

74 Cf. më shumë për këtë në recensionin e shkëlqyer të një prej librave më me ndikim lidhur me teorinë dhe praktikën e kushtetutës së gjallë: Artour Rostorotski, "Book Review –David A. Strauss' *The Living Constitution* (2010)". *German law Journal* Vol. 12 No. 07 (2011) fq. 1545-1552 (në këtë recension të librit, autori jep anët pozitive dhe negative të qasjes origjinaliste dhe i kundërvë ato ndaj qasjes së **kushtetutës së gjallë**, e cila përkrahet në diskursin profesional amerikan me të madhe, përfshirë dhe vetë autorin **David A. Strauss**, librin e të cilit e ka recensuar ky autor).

75 Në literaturë ka pasur në vazhdimësi propozime dhe debate për futjen në lojë të teknikave dhje filozofive tjera të interpretimit kushtetues, siç janë: interpretimi tekstual, interpretimi teleologjik, interpretimi konsensual, strukturalizmi, minimalizmi, doktrinarizmi, pragmatizmi, e deri te shkrirja (fuzioni) i propozuar nga **Ronald Dëorkin** në mes të drejtës kushtetuese dhe filozofisë morale. Cf. Artour Rostorotski, "Book Review –David A. Strauss' *The Living Constitution* (2010)", fq. 1550; Për një diskutim të praktikës gjyqësore të disa prej vendeve ish-komuniste (Çekisë, Hungarisë, Polonisë, Sllovakisë), si dhe të teknikave të interpretimit të përdorura në gjykatat kushteuese të këtyre vendeve, cf. më shumë në Radoslav Prochzka, *Mission Accomplished: On Founding Constitutional Adjudication in Central Europe* (CEU Press: Budapest / New York, 2002) fq . 203-263 (ku autori tregon, bazuar në hulumtimet empirike të praktikës gjyqësore të gjykatave kushtetuese të vendeve në fjalë, se natyra e tekstit ka qenë faktori vendimtar që ka ndikuar në llojin e teknikës së përdorur dhe të aktivizmit të theksuar: aty ku nuk ka pasur një tekst kushtetues përfundimtar, si p.sh në Poloni dhe Hungari, më shumë ka pasur aktivizëm gjyqësor dhe përdorim të argumenteve ekstra-tekstuale; [përveç këtij faktori, një rrethanë tjetër që ka ndikuar në teknikat e interpretimit ka qenë edhe njohurit profesionale të gjyqtarëve dhe formimi i tyre ideologjik dhe kodet interpretuese lokale, të cilat kanë qenë kryesisht kode të bazuara në dogmatizëm dhe formalizëm të trashëguar nga sistemi ish-komunist).

Një koncept që ka lindur në Evropë pas **Luftës së Dytë Botërore** me themelimin e gjykatave kushtetuese i ngjason shumë konceptit amerikan të **kushtetutës së gjallë**. E kemi fjalën për konceptin italian të **diritto vivente**, që më pastaj është përqafuar nga vendet tjera nëpër Evropë dhe gjetiu. Në thelb, shikuar nga këndi i konstitucionalizmit bashkëkohor që për bazë themelore ka supremacinë (epërsinë) e kushtetutës si akt normativ, koncepti i **diritto vivetne** nuk është larg konceptit amerikan mbi **kushtetutën e gjallë**. I vetmi dallim është në mënyrën e arsyetimit të qëllimit përfundimtar që arrihet përmes përdorimit të kësaj teknike dhe filozofie të interpretimit kushtetues. Në vijim diskutojmë më gjerësisht këtë teori dhe këtë praktikë. Mirëpo, paraprakisht, në pak rreshta japim dallimin e këtyre dy koncepteve me një koncept tjetër që më shumë asocohet me aktivizëm gjyqësor të përmasave dramatike në krahasim me dy konceptet e sipër cekura. E kemi fjalën për të a.q. **kushtetutën e padukshme** (**invisible constitution**), që është krijuar nga kryetari i parë i Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë, **Laslo Syjom** (*László* Sólyom: ka shërbyer si kryetar i parë nga viti 1990 deri në vitin 1998) për t'u zbatuar nga kjo gjykatë në vitet e para formative të saj.

Ky koncept është më i ndryshëm nga dy konceptet dhe praktikat si më sipër amerikane e italiane. Më këtë koncept nënkuptohet **forma drastike e aktivizmit gjyqësor**, që bazohet në një sistem dogmash, parimesh dhe metodologjish të fituara duke u mbështetur në mendimin bashkëkohor kushtetues, të përqafuar dhe aplikuar në gjykatat kryesore nacionale dhe ndërkombëtare, përfshirë **Gjykatën Supreme të SHBA**-ve. Thënë me fjalë të tjera, në rastin hungarez të **kushtetutës së padukshme (invisible constitution)**, interpretimi është meta-tekstual, pra del jashtë tekstit kushtetues ekzistues, duke kërkuar parametrat e vlerësimit të kushtetutshmërisë gjetiu në mendimet dhe praktikat bashkëkohore të vendeve dhe gjykatave tjera.[76] Kjo vjen në shprehje në veçanti në kontrollin kushtetues të amendamenteve kushtetuese (kontrolli kushtetues i **pushtetit konstituiv origjiner** dhe **pushtetit konstitutiv derivativ**). Në fakt, kjo praktikë ka lindur në këtë fushë, në **Indi**, ku Gjykata Supreme ka krijuar doktrinën mbi amendamentet e paamendamentueshme kushtetuese, pikërisht duke u bazuar në këtë teknikë interpretimi, e cila zakonisht përmblidhet në frazën e njohur sipas së cilës "e drejta për amendamentim kushtetues nuk është e drejtë për shkatërrim kushtetues".

T'i kthehemi tani dallimeve në mes të konceptit të kushtetutës si **dokument i gjallë** dhe konceptit italian të **diritto vivente**.

Teoria dhe praktika e **diritto vivente** i ngjason shumë teorisë dhe praktikës amerikane të **kushtetutës së gjallë**. Ka lindur për herë të parë në **Itali** në vitin tanimë të largët 1965. Lindja e saj ka qenë në vazhdën e luftës në mes të gjykatave më të larta italiane, **Gjykatës Supreme të Kasacionit** (GJSKIt) dhe **Gjykatës Kushtetuese** (GJKIt.). Kjo e fundit, duke qenë gjykatë e re, në fillim të punës së saj ka hasur në vështirësi të mëdha dhe në rezistencë të **Gjykatës Supreme të Kasacionit**. Për të krijuar një harmoni në mes tyre, dhe për të siguruar zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, kjo e fundit krijoj teknikën e prodhimit të vendimeve të a.q. **sentence interpretative**. Me këto vendime, Gjykata Kushtetuese konfirmon interpretimin e dhënë nga **GJSKIt**, pa marrë parasysh se çfarë thotë teksti kushtetues. Kjo praktikë ka lindur dhe është bërë e mundur përmes dallimit që e ka bërë **GJKIt** në mes të tekstit kushtetues (**disposizione**) dhe përmbajtjes së tij apo sjelljes që kërkohet nga teksti (**norma**).

Ekzistojnë dy forma të **sentenze interpretative:** forma e parë quhet **sentenza intepretativa di rigetto,** kurse e dyta **sentenza interpretativa di accoglimento.** Në rastin e formës së parë, Gjykata i pranon si kushtetuese interpretimet e **GJSKIt** duke u bazuar në **norma** (përmbajtjen e tekstit), jo në tekstin e **disposizione**, ashtu siç kjo kuptohet në praktikën e konsoliduar gjyqësore të instancës më të lartë gjyqësore në Itali. Kjo është njëra prej teknikave mjaft shpesh të përdorura. E kundërta e kësaj është forma e dytë e vendimeve si më sipër: në këto raste, **GJKIt** i pranon si kushtetuese vetëm interpretimin e dhënë nga vetë ajo dhe, për pasojë, e len tekstin e **disposizione** në vend dhe të pandryshuar. Këtu, për dallim nga rasti i parë, nuk pranohen si kushtetuese interpretimet e përmbajtura në **norma** sipas praktikës së konsoliduar të **GJSKIt.** Vetëm lloji i parë i vendimeve paraqesin **diritto vivente**.

[76] Cf. më shumë për këtë, librin e autorit që vetë ka krijuar këtë teori dhe praktikë kushtetuese: Laszlo Solyom **&** Georg Brunner (eds.), *Constitutional Judiciary in a New Democracy: The Hungarian Constitutional Court* (The University of Michigan Press: USA, 2000).

Sikundër shihet, te krijimi i **diritto vivente** objekt kontrolli kushtetutës nuk është teksti i kushtetutës por interpretimi i ligjit ashtu siç është konsoliduar interpretimi i tij në praktikën gjyqësore të **GJSKIt**, si instanca më e lartë e gjyqësorit të rregullt në vend. Përmes kontrollit incidental, që iniciohet nga gjyqësori i rregullt, **GJKIt** vlerëson nëse janë kushtetuese interpretimet e ligjeve të caktuara në praktikën gjyqësore të instancës më të lartë gjyqësore në vend. Këtë përgjigje, ajo e jep duke bërë dallimin në mes të tekstit (**disposizione**) dhe praktikës së konsoliduar në gjyqësorin e rregullt me rastin e zbatimit të tekstit (**norma**). Kjo e dyta, praktika e konsoliduar gjyqësore, përbën objektin e kontrollit kushtetues: kjo teknikë interpretimi ka lindur, sikundër u tha, në vijim të harmonizimit të marrëdhënieve në mes të dy instancave më të larta për dhënien e drejtësisë në **Itali**, GJKIt dhe GJSKIt.[77]

Kjo teknikë dekadave të fundit është rralluar mjaft shumë si pasojë e faktit se Gjykata Kushtetuese u kërkon gjykatave referuese që, kur të dërgojnë pyetje kushtetuese përmes rrugës incidentale, të japin vetë arsyetime të gjata dhe të thella lidhur me dyshimet e tyre për kushtetutshmërinë e një dispozite kushtetuese, përfshirë këtu dyshimet lidhur me **diritto vivente** të konsoliduar në praktikën gjyqësore të **GJSKIt**, si instanca më e larët e gjyqësorit të rregullt në vend. Përveç kësaj, vetë Gjykata Kushtetuese ka shumë kujdes që të ruaj marrëdhëniet e mira me instancën e fundit gjyqësore në vend sepse nga ajo varet vëllimi dhe cilësia e punës: sikundër dihet, **kontrolli incidental** përbën pjesën dërrmuese të lëndëve të **GJKIt**, në ndërkohë që po kjo procedurë përbën rrugën kryesore të frenimit të aktivitetit jokushtetues të parlamentit nacional italian. Tërë kjo, megjithatë, nuk do të thotë se aktivizmi gjyqësor në formën e **diritto vivente** ka marrë fund: ajo ekziston akoma në këtë vend dhe, në ndërkohë, është përhapur, me disa ndryshime të vogla, në shumë vende të **Evropës** kontinentale dhe përtej.[78]

Kuptimi i të **drejtës së gjallë**, i ndërtuar në praktiken gjyqësore italiane si më sipër, ka gjetur shprehje edhe në praktikën e **GJEDNJ**. Në rastin e fundit, megjithatë, bëhet fjalë për një koncept dhe për një praktikë shumë më afër traditës amerikane të dallimit në mes të origjinalizmit dhe kushtetutës së gjallë. Në rastin e **diritto vivente**, sikundër u pa, objekt interpretimi është praktika gjyqësore e gjykatës më të lartë në vend (**norma**) dhe sjellja e kësaj praktike në pajtim me kushtetutën. Në rastin e **Gjykatës së Strasburgut**, termi **instrument i gjallë** (**living instrument**) i referohet botëkuptimit dhe praktikës sipas së cilës **KEDNJ** interpretohet në dritën e ndryshimeve dhe evoluimeve të shoqërisë evropiane dhe koncepcioneve të saj mbi liritë dhe të drejtat e njeriut të sanksionuara me tekstin origjinal të **KEDNJ**. E thënë ndryshe, **Strasburgu** i sheh liritë dhe të drejtat e sanksionuara me Konventë si kategori që i nënshtrohen evoluimit dhe ndryshimit të kuptimit të tyre me kalimin e kohës. Ajo çfarë përbën privatësinë, të drejtën për jetë dhe lirinë e shprehjes duhet të evoluojë së bashku me zhvillimet teknologjike dhe shoqërore. Kjo qasje e përditësuar ndaj Konventës nuk përbën një përmbysje, por një përfundim logjik që duhet të nxirret nga objekti dhe qëllimi i saj dhe që ka të bëjë me mbrojtjen efektive e kuptimplote të lirive dhe të drejtave individuale.

Termi **instrument i gjallë**, i zhvilluar në praktikën e **Gjykatës së Strasburgut**, ka çuar në përqafimin dhe zgjerimin e lirive dhe të drejtave të garantuara me Konventë konform zhvillimeve moderne dhe ndryshimeve në qasjet mbizotëruese shoqërore. Gjykata në këtë mënyrë synon afrimin e një interpretimi të Konventës që mbron dhe promovon liritë dhe të drejtat nga ky dokument në mënyrë efektive dhe praktike, jo si një mbrojtje dhe promovim iluzor dhe teorik. Në këtë kuptim, më emblematik është neni

---

77 Stefano Evangelista and Giovanni Canzio, "Corte di cassazione e diritto vivente" *Il Foro Italiano* Vol. 128 No. 4 (Aprile 2005), fq. 82-88; Giancarlo Rolla & Tania Groppi, "Between Politics and law: The Development of the Constitutional Review in Italy". Në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective* (Kluwer law International: The Hague, 2010) fq. 143-159); Maartje de Visser*, Constitutional Review in Europe A Comparative Analysis,* fq. 286-291; Salvatore Sica, "Il valore del precedente: attuale dimensione del diritto 'vivente'". *Federalizmi.it* (Rivista di Diritto Italiano, Comparato, Europeo) n. 18 (2018) fq. 1-10.

78 Cf. Massimo Cavino (ed.), *Esperienze di diritto vivente. La giurisprudenza negli ordinamenti di diritto legislativo. Vol. 1. Italia, Francia, Belgio,Germania, Spagna, Portogallo, Brasile, Argentina, Colombia* (Giuffrè Edittore: Milano, 2009); Anna Silvia Bruno & Massimo Cavino (eds.), *Esperienze di diritto vivente. La giurisprudenza negli ordinamenti di diritto legislativo. Vol. 2. Italia, Messico, Peru', Cile, Bolivia, Svezia, Norvegia, Finlandia, Danimarca, Russia, Polonia, Romania, Ungheria, Croazia* (Giuffrè Edittore: Milano, 2011).

8 ["E drejta për respektim të jetës private dhe familjare"] të **KEDNJ** dhe interpretimi që ky nen ka fituar në praktikën e **GJEDNJ**: interpretimi ka përfshirë një gamë të gjerë të lirive dhe të drejtave individuale, duke përfshirë këtu, në mes tjerash, integritetin fizik dhe psikologjik, seksualitetin, gjininë, mbrojtjen e të dhënave, reputacionin, si dhe mbrojtjen e ambientit. Në fillim, sikundër dihet, vetë Konventa dhe ky nen kanë qenë të draftuar me qëllim të vetëm mbrojtjen nga praktikat e shteteve totalitare të asaj kohe: ai lloji shteti në kohën e lindjes së Konventës ka shërbyer si mbikëqyrës i jetës private dhe familjare të individit. Sot, dihet shumë mirë, nuk është vetëm shteti totalitar ai që cenon liritë dhe të drejtat nga neni 8 i **KEDNJ**, por edhe akterët tjerë joshtetërorë.[79]

Nga sa më sipër, shihet se disa prej teorive dhe praktikave interpretuese kanë të bëjnë me funksionin transformues të gjykatës kushtetuese dhe të gjykatave ekuivalente me to, përfshirë këtu **GJEDNJ**, kurse disa sosh nuk kanë të bëjnë aq shumë me aktivizmin gjyqësor. Në rastin e parë bëhet fjalë për një aktivitet legjitim të gjykatës kushtetuese dhe të gjykatave ekuivalente me to, përfshirë këtu **GJEDNJ**, nisur nga fakti se përmes këtij aktiviteti kushtetuta dhe teksti i saj bëhen harmonik me trendet zhvillimore të një shoqërie. Në rastin e dytë, ndërkaq, bëhet fjalë për një aktivitet jolegjitim, sepse veprimi shkon përtej normës kushtetuese dhe normës tjetër referente mbi juridiksionin material duke futur bindjet personale të gjyqtarëve në germën dhe frymën e kushtetutës nacionale. Thënë ndryshe, deri sa te ideja e kushtetutës si **dokument i gjallë** bëhet fjalë për një interpretim evolutiv të tekstit konform ndryshimit të rrethanave shoqërore, në rastin e **aktivizmit gjyqësor** bëhet fjalë për një ndryshim evolutiv dhe uzurpator të kompetencave materiale të organit tjetër, në rend të parë të ligjvënësit dhe vetë sovranit (kur bëhet fjalë për ushtrimin e pushtetit konstitutiv origjiner dhje derivativ nga ana e gjykatës kushtetuese apo nga ana e gjykatës tjetër ekuivalente me të), por edhe të degëve të tjera të pushtetit shtetëror. Rastit të parë i korrespondon teoria dhe praktika mbi kushtetutën si instrument i gjallë (**living constitution/living instrument**), kurse të dytit teoria dhe praktika hungareze mbi kushtetutën e padukshme (**invisible constitution**) dhe teoria dhe praktika italiane mbi të drejtën e gjallë (**diritto vivente)**, ashtu siç u përshkruan më sipër.

Kjo deri këtu kryesisht ka pasur të bëjë me sferën e pushtetit kushtetutëbërës apo me ushtrimin e **pushtetit konstituiv** nga ana e gjykatave kushtetuese. Në sferën e funksionit ligjvënës, aktivizmi gjyqësor gjithashtu ndryshon. Edhe këtu si parametër matës është e drejta kushtetuese materiale e përmbajtur në kushtetutën nacionale dhe në parametrat tjerë matës, të cilët shërbejnë si mjet për të vlerësuar nëse është lënduar supremacia (epërsia) e normave kushtetuese që përbëjnë kuadrin material dhe procedural për prodhimin e normave ligjore. Kjo në veçanti është e theksuar në **kushtetutat e vendeve ish-komuniste**, të cilat, për dallim nga demokracitë e vjetra, kanë parashikuar në mënyrë shprehimore supremacinë (epërsinë) e kushtetutës ndaj çdo norme tjetër, përfshirë këtu marrëveshjet dhe instrumentet tjera ndërkombëtare.[80]

Në literaturë është vërejtur se, krahas kësaj si më sipër, shkalla dhe intensiteti i ndërhyrjes dhe zëvendësimit të gjykatës kushtetuese me ligjvënësin dhe punën e tij varet nga mënyra se si ligjvënësi përllogaritë çmimin dhe përfitimet e ligjit konkret: nëse përfitimet janë ndërtuar ngushtësisht, atëherë edhe ndërhyrja dhe zëvendësimi i gjykatës kushtetuese me ligjvënësin dhe punën e tij do të jetë më i madh, dhe anasjelltas, sa më gjerësisht të jetë ndërtuar përllogaritja e çmimit dhe përfitimeve që sjell ligji, aq më pak do të ketë nevojë për ndërhyrje të gjykatës kushtetuese dhe zëvendësim të saj me punën e lig-

---

79 Cf. më shumë për këtë në shkrimin e shkëlqyer Stefan **Theil**, "Is the 'Living Instrument' Approach of the European Court of Human Rights Compatible with the ECHR and International law?" *European Public law* Vol. 23 Issue 3 (2017), fq. 587–614.

80 Në shumicën e vendeve ish-komuniste në mënyrë shprehimor ndalohet me kushtetutë lidhja e marrëveshjeve dhe traktateve ndërkombëtare që bien ndesh me kushtetutën; kjo nënkupton se kushtetutshmëria e marrëveshjeve dhe traktateve ndërkombëtare duhet të sigurohet gjatë procesit të lidhjes, implementimit dhe përfundimit të tyre. Cf. Anneli Albi, *EU Enlargement and the Constitutions of Central and Eastern Europe* (Cambridge University Press: Cambridge, 2005) fq. 171-175.
Kjo është kështu edhe në Kosovë: neni 18.4 ["Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare"] I Kushtetutës duhet të kuptohet në këtë kuptim, pra që të gjitha fazat e lindjes së një marrëveshjeve apo traktati ndërkombëtar zbatohen me rastin e çdo amendamentimi apo tërheqjeje nga to dhe për këtë duhet pasur shumë kujdes.

jvënësit.[81] E njëjta logjikë vlen, **mutatis mutandis**, edhe për normat tjera që kanë natyrë të përgjithshme, por që nuk nxirren nga parlamenti nacional (ose, nxirren nga ai, por kanë për objekt normimin e funksionimit dhe organizimit të tij të brendshëm, siç janë, ta zëmë, rregulloret dhe aktet e tjera të përgjithshme që normojnë jetën parlamentare), si dhe për të gjitha aktet juridike individuale të organeve shtetërore dhe të organeve tjera publike që kanë autorizime ligjore të bazuara në kushtetutë për të prodhuar norma juridike, përkatësisht për të nxjerrë akte juridike në vijim të ushtrimit të kompetencave të tyre kushtetuese. Në këtë kuptim, në kontekstin kosovar, dy vendime të Gjykatës Kushtetuese janë me rëndësi për t'u zënë në gojë, të njohura respektivisht si **rasti i qarkores qeveritare**[82] dhe **rasti i rrogave,**[83] të cilat duhet të analizohen me qëllim që lexuesit t'i kontekstualizohet shkalla e aktivizmit gjyqësor në sferën e përligjjes nga ana e Gjykatës Kushtetuese të aktivitetit ligjvënës të ekzekutivit kosovar.

Me vendimin e parë, **rasti i Qarkores Qeveritare**, Gjykata Kushtetuese ka interpretuar domethënien e shprehjes kushtetuese nga neni 113.2 ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] i Kushtetutës[84], përkatësisht ka interpretuar shprehjen **rregulloret e Qeverisë**: kjo shprehje ka kuptimin që përfshinë çdo akt juridik të përgjithshëm që Qeveria nxjerrë në vijim të ushtrimit të kompetencave të saj kushtetuese.[85] Për dallim nga dekretet e Qeverisë, që është një akt individual zakonisht i pa arsyetuar, ky kuptim përfshinë të gjitha aktet e përgjithshme juridike që nxjerr ekzekutivi në vijim të ekzekutimit të kompetencave që kanë të bëjnë kryesisht me zbatimin e ligjeve në kuptim të nenit 93.4 ["Kompetencat e Qeverisë"] të Kushtetutës. Kjo është krejtësisht e kuptueshme nëse kihet parasysh fakti se fjala **dekret**, siç është përdorur në dispozitën e sipërcekur të nenit 113.2 të Kushtetutës ka kuptimin e vendimit qeveritar, përfshirë të gjitha vendimet administrative të ministrive dhe degëve të tjera të pushtetit ekzekutiv që janë në ngarkesë për të ushtruar të gjitha kompetencat nga neni 93 i Kushtetutës, përveç pikës 4 të të njëjtit nen.

T'i kthehemi tani sferës së aktivizmit gjyqësor në këtë rast. Ai nuk shprehet në definimin si më sipër me karakter interpretativ të kuptimit të shprehjes **rregullore qeveritare**, por në përmbajtjen e kërkesës (**petitum**-it) të parashtruesit: në këtë rast, Avokati i Popullit kishte kërkuar që të bëhej vlerësimi i kushtetutshmërisë së një **qarkoreje administrative** të Ministrisë së Administratës Publike (**MAP**), e cila, sipas tij, cenonte garancionet kushtetuese mbi pavarësinë e institucioneve të pavarura nga kapitulli XII i Kushtetutës. Në këtë kategori, Avokati kishte futur edhe vetë Gjykatën Kushtetuese (sic!). Arsyetimi për këtë **aktivizëm gjyqësor** u gjet në faktin se Gjykata Kushtetuese dhe Institucionet e Pavarura nga kapitulli XII nuk ishin pjesë e asnjërit prej tri pushteteve, kurse për vetë Gjykatën Kushtetuese u përdor argumenti i pavarësisë së gjyqësorit të rregullt (sic!).[86]

---

81 Gustavo Femandes de Andrad, "Comparative Constitutional law: Judicial Review". *Journal of Constitutional law* Vol. 3 No. 3 (May 2001) fq. 977-989 në fq. 985-986.

82 *Rasti KO 73/16. Aktgjykim. Parashtrues: Avokati i Popullit. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Qarkores Administrative nr. 01/2016, të nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike të Republikës së Kosovës, me 21janar 2016.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 8 dhjetor 2016. Nr. ref.: AGJ 1015/ 16 . Në këtë rast, objekt i procedurës ka qenë vlerësimi i kushtetutshmërisë së një akti të përgjithshëm të Qeverisë, përkatësisht i një akti që implementon një normë tjetër të përgjithshme që ka natyrë ligjore.

83 *Rasti KO 12/18. Aktgjykim. Parashtrues: Albulena Haxhiu dhe 30 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 04/20, të 20 dhjetorit 2017*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 11 qershor 2018. Nr. ref.: AGJ 1258/ 18. Në këtë rast, objekt i kontrollit kushtetues ka qenë një vendim i Qeverisë për **rritjen e rrogave** funksionarëve shtetërorë dhe vartësve të tyre. D.m.th. bëhet fjalë për një vendim individual të Qeverisë me të cilin janë **rritur rrogat** me efekt retroaktiv që nga data e nxjerrjes së vendimit (dhjetor 2017). Çështja kontestuese kushtetuese ka qenë nëse Qeveria ka pasur të drejtë të bëj një gjë të tillë jashtë përcaktimeve ligjore që normojnë buxhetin nacional të Kosovës për çdo vit.

84 Neni 113.2 ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] i Kushtetutës:
"[…] 2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:
(1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit
dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën".

85 Cf. paragrafët 49, 53-54, 56, 58 & 100 të Aktgjykimit në rastin **KO 73/16.**

86 Cf. paragrafët: 84-86, 92-97 të Aktgjykimit në rasti **KO 73/16.**

Asnjëherë nuk mund të kenë status të njëjtë Avokati i Popullit dhe Gjykata Kushtetuese, as në Kosovë e as gjetiu në Evropë, për faktin e thjeshtë se i pari paraqitet si palë në procedurat pranë subjekti të dytë, siç paraqiten krejt palët që kanë status të privilegjuar në procedurë në kuptim të nenit 113 pikat 2, 3 dhe 9 ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] të Kushtetutës. Fundja, as vendimet e Avokatit të Popullit nuk kanë karakter të detyrueshëm, gjë që nuk është rasti me vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Për vendimet e Gjykatës flasim në dy kapitujt në vijim, në ndërkohë që këtu, para se të dalim nga kjo pjesë e diskutimit, shënojmë se, për dallim nga Gjykata Kushtetuese, Avokati i Popullit dhe tjerat institucione të pavarura nga kapitulli XII i Kushtetutës i përgjigjen ose legjislativit ose ekzekutivit, si themelues të tyre. Gjykata Kushtetuese, ndërkaq, për punën e vet, nuk i përgjigjet asnjë institucioni pos Kushtetutës, gardian i së cilës është. Gjykata Kushtetuese, thënë me fjalë të tjera, nuk ka themelues mbi veten e saj por përbën një pushtet të konstituar (***pouvoir constitué***) me juridiksion të qartë të përcaktuar me Kushtetutë dhe rrinë mbi të gjithë pikërisht për faktin se interpreton normën e të gjitha normave.

Të shohim nga afër tani rastin tjetër, **vendimin për Rastin e Rrogave**. Në këtë rast, **aktivizmi gjyqësor** shprehet më ndryshe, përkatësisht në sferën e të drejtën kushtetuese materiale, duke ia dhënë Qeverisë së Kosovës të drejtën e caktimit me vendim individual të rrogave të funksionarëve të lartë shtetëror dhe personelit që punon në zyrat e saj, përfshirë sistemin e drejtësisë, në tërësi jashtë parametrave ligjor të përcaktuar me buxhetin nacional.

Rasti i **vendimit për Rrogat** duhet të shikohet në dritën e jurisprudencës së mëhershme të Gjykatës Kushtetuese. Pa këtë jurisprudencë nuk mund të kuptohet aktivizmi gjyqësor në **rastin e Rrogave**. Fjala është për rastin **KO 118/13**,[87] i marrë më datën 9 shtator 2013. Ky vendim ka vendosur mbi kushtetutshmërinë e **Ligjit Nr. 04/L-201 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-16 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013** (**Ligjit Nr. 04/L-201**), i propozuar nga Qeveria e Kosovës. Me këtë rast, Gjykata pat vendosur se rasti është i palejueshëm për shqyrtim dhe vendosje meritore, për shkak të arsyeve që i tregojmë në vijim të këtij seksioni. Vetë rasti, ndërkaq, u iniciua nga deputetët e opozitës: pretendimi i tyre konsistonte se **Ligji Nr. 04/L-201** cenonte dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, Ligjit Nr. 03/L-048. Kur hodhi poshtë kërkesën si të palejueshme në këtë rast, Gjykata konstatoi se, në bazë të nenit 112.1 ["Parimet e Përgjithshme"] të Kushtetutës, ajo ishte kompetente për të vlerësuar vetëm kushtetutshmërinë e ligjit të kontestuar, jo ligjshmërinë e tij.[88]

Përkundër asaj që kërkesa e parashtruesve që shpallur e palejueshme në rastin **KO 118/13**, Gjykata, megjithatë, konstatoi se, sipas Kushtetutës, vetëm Qeveria mund të përcaktojë buxhetin kombëtar,[89] për të ardhur deri te konstatimi se, me miratimin e **Ligjit Nr. 04/L-201** Kuvendi nuk ka cenuar në mënyrë të palejueshme me Kushtetutë të drejtën për të miratuar buxhetin dhe për të kontrolluar zbatimin e tij. Kjo e fundit, miratimi dhe kontrollimi i zbatimit të buxhetit, është prerogativë e Kuvendit, siç është tagër i Qeverisë përcaktimi, përmes propozimit ligjor, i buxhetit kombëtar. Në këtë drejtim, pra, është e pakontestueshme dhe krejt e qartë se Qeveria ka kompetencë për të përcaktuar buxhetin nacional përmes ligjeve, asnjëherë përmes vendimeve individuale apo akteve tjera që kanë natyrë të akteve të përgjithshme: miratimi i buxhetit është kompetencë ekskluzive e Kuvendit siç është kompetencë e tij ekskluzive edhe kontrolli mbi zbatimin e buxhetit në pajtim me ligjin për buxhet, të cilin e miraton vet.

Duke marrë parasysh se vendimi i Qeverisë për rritjen e pagave, i cili ka qenë objekt i kontrollit kushtetues, nuk ishte paraparë sipas Ligjit për Buxhetin, atëherë Kuvendit i takonte e drejta për të kërkuar llogari nga Qeveria në lidhje me zbatimin e buxhetit, **zbatim që është bërë me vendimin e Qeverisë në një mënyrë arbitrare, jo me ligjin për buxhet për vitin kur u mor vendimi i Gjykatës.** Kjo do të thotë se korniza e zbatimit dhe e shpenzimit të buxhetit të Kosovës bëhet në pajtim me ligjin për buxhet si-

---

87 *Rasti KO 118/13. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Albana Fetoshi dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës . Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 04/L-201 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtinë, më 9 shtator 2013. Nr. ref˙: RK 470/ 13.

88 Cf. paragrafi 38 i Aktvendimit në rastin **KO 118/13**.

89 Cf. paragrafi 52 i Aktvendimit në rastin **KO 118/13.**

pas vitit të miratimit të tij dhe se ka llogaridhënie në rast se ai buxhet zbatohet dhe shpenzohet jashtë kornizës së paracaktuar ligjore. Kjo llogaridhënie duhet të kërkohet nga Kuvendi, i cili ka të drejtë për të ditur si po shpenzohet paraja publike nga tjerët, përfshirë ekzekutivin e vendit. Ndër vendimet që duheshin mbikëqyrur nga Kuvendi hyn edhe ai për rritjen e pagave jashtë kornizës së paraparë bugjetore: vendimi i Qeverisë për **rritjen e rrogave** ka ndryshuar buxhetin e Kosovës sepse ka dalur jashtë kornizës së përcaktuar ligjore. Çdo shpenzim i buxhetit duhet të jetë në pajtim me përcaktimet ligjore. Qeveria ka pasur mundësi që përmes **Ligjit nr. 04/L-165** të parashikoj një shpenzim të tillë, asnjëherë përmes veprimeve arbitrare në kundërshtim me kompetencat ekskluzive kushtetuese të Kuvendit. **Me këtë veprim ekzekutivi kosovar ka uzurpuar kompetencat e Kuvendit për normëvënie në sferën e zbatimit dhe shpenzimit të buxhetit nacional.** Ky uzurpim është dashur të konstatohet dhe sanohet nga Gjykata, sepse detyrë e saj është, **inter alia**, që të mbikëqyrë nëse organet shtetërore ushtrojnë autorizimet e tyre në pajtim me përcaktimet kushtetuese. Jo vetëm që Gjykata nuk ka bërë një gjë të tillë, por edhe e ka shpallur vendimin e Qeverisë si vendim me legjitimitet kushtetues, si në aspektin e lejueshmërisë së rastit ashtu edhe sa i përket meritave (substancës) së tij: pas shpalljes së rastit si të lejueshëm, Gjykata ia ka njohur Qeverisë së Kosovës të drejtën për caktim arbitrar të rrogave, jashtë përcaktimeve kushtetuese dhe ligjore (të ligjit përkatës mbi buxhetin nacional).

Nga arsyetimi i Gjykatës Kushtetuese në rastin **KO 118/13** shihet qartë se me vendim të Qeverisë nuk mund të bëhet rritja e rrogave. Ndërhyrjet në zbatim dhe shpenzim të buxhetit nacional mund të bëhen vetëm nëse bëhet fjalë, siç thuhet në rastin **KO 118/13**, për vënien në jetë të një detyrimi ndërkombëtar, gjithnjë duke mos cenuar autonominë e buxhetit nacional.[90] Ky nuk ka qenë rasti me rritjen arbitrare të pagave, të cilin Gjykata Kushtetuese e ka vendosur në favor të ekzekutivit duke i dhënë atij të drejtën e ndërhyrjeve në zbatim dhe shpenzim të buxhetit jashtë syve të organit përfaqësues të vullnetit të sovranit - Kuvendit të Kosovës. Thënë ndryshe, në **rastin e rrogave** nuk ka qenë fjala për zbatim nga ana e qeverisë të një detyrimi ndërkombëtar apo të ndonjë obligimi tjetër kushtetues, por për rritjen arbitrare të rrogave të zyrtarëve të lartë shtetëror në Kosovë. Ky hap i saj ka cenuar rënd autonominë e buxhetit të përcaktuar me propozim të vetë asaj, dhe të miratuar nga Kuvendi. Nuk diskutohet që qeveria dhe vetëm ajo mund ta caktojë shumën e tërësishme të buxhetit nacional, por në formë dhe përmes ligjit, jo me vendim arbitrar. Ajo, qeveria, asnjëherë nuk mund të ekzekutojë të njëjtin, buxhetin, pa qenë një gjë e tillë e paracaktuar me ligjin për buxhetin për vitin përkatës. Kjo është kështu sepse një veprim i tillë i ekzekutivit prish autonominë buxhetore edhe vetë sigurinë juridike dhe ekonomike në vend.

E tërë kjo lidhet me natyrën juridike të precedentit, gjë për të cilën kemi folur në kapitullin pararendës, por edhe me vetë fizionominë e gjyqësisë kushtetuese të **modelit evropian/kelsenian**: në themel të gjenezës së institutit të kontrollit të kushtetutshmërisë qëndron ideja e mbrojtjes së supremacisë (epërsisë) së kushtetutës, jo ofrimi i mundësisë për ndërtimin e një sistemi tjetër të pushtetit me autorizime për **normëvënie ekstra-parlamentare.** Ky koncept është pasojë e kuptimit material (përmbajtësor) të konstitucionalizmit bashkëkohor, me të cilin nënkuptohet kuadri juridik për qeverisjen e kufizuar me kompetenca qarta të përcaktuara me kushtetutë, në qendër të së cilit është gjyqësia kushtetuese, po ashtu me juridiksion të qartë kushtetues, e cila për qëllim parësor ka sigurimin e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës dhe pengimin e ushtrimit të pushtetit normëvënës jashtë parametrave të përcaktuar kushtetues. Në pengesat për ushtrimin e pushtetit normavënës jashtë parametrave kushtetues qartësisht të përcaktuar hyn edhe korpusi i lirive dhe të drejtave kushtetuese, të cilat duhet t'i ketë parasysh secili që ushtron pushtet shtetëror apo publik. Ky koncept i kuadrit juridik brenda të cilit duhet të lind dhe legjitimohet ushtrimi i pushtetit shtetëror apo publik qartë nxjerr në pah faktin se kompetencat e gjykatave kushtetuese, brenda juridiksionit kushtetues që ushtrohet me një mandat të qartë po ashtu kushtetues, përbëjnë pikën themelore nisëse për vlerësimin e aktivizmit gjyqësor dhe antipodit të tij **- vetëpërmbajtjes gjyqësore**. Këtë të fundit e diskutojmë në seksionet në vijim.

[90] Cf. paragrafët 47-50 të Aktvendimit në rastin **KO 118/ 13 .**

Gjykatat kushtetuese interpretojnë normat ekzistuese, nuk krijojnë norma të reja. Pas interpretimit të dhënë nga gjykata kushtetuese, norma nuk mund të ketë asnjë kuptim tjetër përveç kuptimit të shprehur në vendimin e saj meritor. Kjo përbën precedent për të gjithë të tjerët, siç e kemi theksuar në kapitullin pararendës, precedent që duhet të respektohet si pasojë e **efektit të përgjithshëm** (erga omnes) të vendimeve të gjykatave kushtetuese. Po ashtu, siç kemi sqaruar në kapitullin pararendës, kjo nuk vlen për dhënësin e vendimit meritor, gjykatën kushtetuese, e cila në çdo kohë mund të ndryshoj precedentin e vet, me një arsyetim të qartë dhe të thellë ku të reflektohen në mënyrë të qartë arsyet e ndryshimit të precedentit ekzistues (krahas arsyeve që lidhen me verdiktin meritor). Kjo nënkupton që vetëm me aktgjykim si formë e vendimit meritor precedenti mund të krijohet, prishet dhe ndryshohet. Edhe këtë e kemi diskutuar në kapitullin pararendës. **Thënë me fjalë të tjera, vetëm vendimi meritor i gjykatës shërben si pikë referimi për interpretim të normës kushtetuese dhe, për pasojë, për sigurim të supremacisë (epërsisë) së këtyre normave kundrejt çdo norme tjetër në një rend juridiko-kushtetues.**

Në vijim të këtij argumentimi si më sipër, pyetja që shtrohet, është kjo: ku qëndron gabimi i Gjykatës në rastin e rrogave? U mor vesh, gjithnjë në kontekst të aktivizimit gjyqësor në të cilin është angazhuar ajo në këtë rast. Nga diskutimi i sipërm nuk është vështirë të merret vesh se në **rastin e rrogave**, Gjykata ka krijuar një precedent të rrezikshëm në sferën e të **drejtës kushtetuese materiale** sepse ia njohu ekzekutivit të drejtën për të vendosur në mënyrë arbitrare për çështjet që kanë të bëjnë me autonominë buxhetore, e cila përcaktohet nga Kuvendi me ligj.[91] Ky vendim prish sigurinë e përgjithshme në Kosovë, jo vetëm sigurinë juridike, por edhe atë socio-ekonomike: nëse sot ekzekutivi ka të drejtë t'i rrisë rrogat me vendim individual, të paarsyetuar dhe pa mbështetje në ligjin përkatës mbi buxhetin, atëherë nesër i njëjti ekzekutiv mund të marrë vendim individual për të ulur të njëjtat rroga me vendim individual arbitrar. Përveç kësaj, nëse sot kjo lejohet të bëhet me vendim, atëherë nëse ekzekutivi mund të marrë vendime në mënyrë arbitrare, jo për të konkretizuar një kompetencë të tij ligjore, të bazuar në Kushtetutë, por për të ushtruar ligjvënie autonome, prerogativë kjo që i takon vetëm Kuvendit. **Ajo që prezumohet është kushtetutshmëria e ligjit, asnjëherë kushtetutshmëria e vendimeve individuale të ekzekutivit dhe organeve të tjera të administratës shtetërore.** Është krejtësisht logjike që aktet individuale të administratës shtetërore mos të gëzojnë cilësinë e prezumimit të kushtetutshmërisë sepse në mes tyre dhe aktit më të lartë juridik në vend qëndron një ligj (ose normë tjetër e përgjithshme), kushtetutshmëria e të cilit prezumohet. Përveç kësaj, ajo normë e përgjithshme ligjore ose tjetër konkretizohet me një vendim administrativ ashtu që nuk ka asnjë kuptim që të prezumohet kushtetutshmëria e veprimit individual të ekzekutivit në mënyrë (dhe me intensitet) të njëjtë si kushtetutshmëria e produktit të përfaqësuesit të sovranit – ligjvënësit.

U mor vesh, precedenti mund të prishet edhe me **amendament kushtetues**, krahas ndryshimit të precedentit nga vetë gjykata kushtetuese. Amendamenti që ka të bëjë me ndryshimin e një norme kushtetuese të interpretuar me **vendim meritor të gjykatës kushtetuese** mund të konfirmojë, plotësoj ose ndryshoj precedentin e vënë nga gjykata kushtetuese. Që në momentin e miratimit dhe hyrjes së tij në fuqi, amendamenti bëhet normë kushtetuese e barabartë me normat tjera ekzistuese, por vetëm në aspektin

---

[91] Thuajse dy vite pas shkrimit të këtyre rreshtave nisi pandemia **COVID-19**. Kosova u fut në vorbullën e masave emergjente, siç u futën pjesa dërrmuese e shteteve të botës diku nga marsi i vitit 2020. Më datën 23 mars 2020, Qeveria mori një vendim me të cilin, pa asnjë bazë ligjore, bëri kufizimin e lirisë së lëvizjes, lirisë së tubimit dhe të drejtës për privatësi në tërë territorin e Kosovës dhe ndaj tërë njerëzve që gjendeshin nën juridiksionin e saj. Kjo ishte në kundërshtim me neni 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës, i cili lejon kufizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut vetëm me ligj. Kjo nënkupton se Qeveria i uzurpoi kompetencat ligjvënëse sepse, pa asnjë bazë ligjore, bëri kufizimet e lirive dhe të drejtave si më sipër. Në fakt, ajo që ka bërë Qeveria, përbën derogim (pezullim) të lirive dhe të drejtave të njeriut, që mund të ndodhë vetëm në gjendje të jashtëzakonshme të shpallur nga **Kuvendi i Kosovës**. Këtë rast e kemi diskutuar në seksionin 11.3.3 të kapitullit të njëmbëdhjetë. Për tekstin e plotë të vendimit të Gjykatës, cf. *Rasti KO 54/20. Aktgjykim. Parashtrues: Presidenti i Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 01/15 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të 23 marsit 2020.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 6 prill 2020. Nr. ref.: AGJ 1543/20. Sikundër shihet, në këtë rast Gjykata ka gjetur shkelje të Kushtetutës, në ndërkohë që në **rastin e Rrogave** kishte vendosur se kërkesa ishte e papranueshme, ani se bëhej fjalë për çështje tërësisht të njëjtë kushtetuese - uzurpim pa të drejtë i funksionit ligjvënës nga ana e ekzekutivit të **Kosovës**.

formal. Në aspektin substancial (material), ndërkaq, norma e krijuar me amendament kushtetues mund të ketë fuqi më të madhe juridike se disa apo të gjitha normat tjera kushtetuese (ta zëmë, norma e re e krijuar me amendament mund të përcaktojë kritere të reja dhe ndalesa të reja për amendamentim të pjesëve të caktuara të kushtetutës, apo të disa pjesëve të saj, ndalesa që më parë nuk kanë ekzistuar në kushtetutë).

Nga ky vështrim telegrafik i historikut të kontekstit të lindjes së **aktivizimit gjyqësor**, qartë vërehet se sfera e kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë përbën strofullin ku strehohet qeveria dhe rezerva të cilën akterët shtetërorë, të gjithëve përveç gjykatës kushtetuese, por edhe publiku e shoqëria civile e kanë ndaj **aktivizmit gjyqësor**. Këto neveri dhe rezerva përbëjnë esencën e imazhit negativ që asocohet kryesisht me sferën e kontrollit abstrakt të normës. Kjo është kështu sepse sfera e kontrollit abstrakt prek në mënyrë të drejtpërdrejtë vullnetin e përfaqësuesit të sovranit: çdo ndërhyrje e akterëve jashtë parlamentar në formimin e normës juridike përbën një problem në vete. Këtu është gjeneza e lindjes dhe e vetë problemit kryesor me **aktivizmin gjyqësor** në materien kushtetuese. Kjo lidhet me vetë natyrën e formimit të vullnetit të përfaqësuesit të sovranit si normëvënës, i cili formim zhvillohet nën hijen e fortë të një sfondi ngjarjesh shumë të ndërlikuara që prekin problemet kardinale politike, sociale, ekonomike dhe kulturore të një kohe dhe hapësire konkrete.

Ky formim i ndërlikuar i vullnetit të përfaqësuesit të sovranit duhet të matet dhe krahasohet me normat kushtetuese që janë akoma më të përgjithshme dhe më abstrakte se normat tjera të prodhuara nga përfaqësuesi i sovranit - parlamenti nacional. Kjo matje për qëllime të krahasimit të normave kushtetuese me normat tjera të përgjithshme kryhet përgjatë procesit të **sillogjizmit gjyqësor.** Për dallim nga ligjet, kushtetutat përmbajnë norma e parime të përgjithshme që në çdo kohë kërkojnë interpretime dhe gjykime të balancuara **ad hoc**, për t'i përshtatur ato me situatat dhe rrethanat e reja dhe konkrete. Kjo kërkon vetëpërmbajtje nga ana e gjyqtarëve kushtetues sepse hapësira për manovrim është tejet e gjerë, si pasojë e natyrës së përgjithësuar të dispozitave kushtetuese, ashtu që shpërdorimi paraqitet si diçka potencialisht e mundshme. E thënë ndryshe, **aktivizmi gjyqësor**, në këtë sferë, është shumë më i mundshëm se me rastin e ushtrimit të kontrollit kushtetues në procedurat për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave individuale dhe në procedurat tjera që më rrallë vihen në lëvizje në praktikën e gjykatave kushtetuese. Kjo rrethanë dëmton legjitimitetin e ushtrimit të gjyqësisë kushtetuese dhe, për pasojë krijon rezerva serioze ndaj ushtrimit të kontrollit të kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese. Këto rezerva zakonisht formulohen me shprehjen **vështirësia kundërmazhoritare**, përkatësisht me shprehjen që përshkruan uzurpimin pa të drejtë nga ana e gjyqësisë kushtetuese të funksionit normëvënës: gjyqësia kushtetuese nuk ka bazë demokratike, për dallim nga përfaqësuesi i sovranit që i nënshtrohet zgjedhjeve si forma themelore për legjitimim politik (krahas formave të tjera më pak të përdorura, siç janë referendumi dhe format tjera të deklarimit të vullnetit).[92]

Në një gjykim abstrakt të kontrollit të kushtetutshmërisë së normave juridike (ligjore apo kushtetuese), procesi i **silogjizmit gjyqësor** është delikat dhe specifik sepse si fakte paraqiten rrethanat nën të cilat janë ndërmarrë veprimet e përfaqësuesit të sovranit gjatë normëvënies. Si prova që vërtetojnë këto fakte, ndërkaq, janë materialet e prodhuara me rastin e normavënies së tillë. Procesi i vlerësimit të tyre, që kryhet përmes **subsumcionit** (**sillogjizmit**), nuk mund të lëshohet në analizën dhe vlerësimin e fakteve jetësore politike, sociale, ekonomike dhe kulturore që kanë shtyrë normëvënësit për normëvënien e tillë. Këto fakte jetësore analizohen dhe vlerësohen vetëm nga sovrani dhe përfaqësuesi i tij–parlamenti nacional, kurse gjykatat kushtetuese në procesin e **silogjizmit gjyqësor** (**subsumcionit**) merren vetëm me analizën dhe krahasimin e dy normave, njëra prej të cilave është kushtetuese dhe komandon parametrat për vlerësim të fuqisë juridike të normës tjetër më të ultë se vetë ajo.

---

[92] Gonçalo de Almeida Ribeiro, "Judicial Activism and Fidelity to law". Në Luís Pereira Coutinho, Massimo La Torre & Steven D. Smith (eds.), *Judicial Activism.An Interdisciplinary Approach to the American and European Experiences*, fq. 44-45; Lidhur me **vështirësinë kundërmazhoritare**, cf. më shumë Valentina Volpe, "Drafting Counter-majoritarian Democracy. The Venice Commission's Constitutional Assistance", *Heidelberg Journal for International law, ZaöRV* Vol. 76 No. 4 (2016).

Vlerësimi i rritjes së **aktivizmit gjyqësor** gjatë dekadave të fundit ka ndodhur pikërisht duke pasur parasysh këtë dallim, përkatësisht dallimin në mes të fakteve si rrethana jetësore që vlerësohen dhe analizohen nga normëvënësi me rastin e normavënies dhe fakteve si rrethana jetësore që vlerësohen dhe analizohen nga gjykatat kushtetuese me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së normëvënies, si të procesit ashtu edhe të vetë materies së prodhuar në një proces të tillë. Procesi i rritjes së aktivizmit gjyqësor dekadave të fundit ka shkuar aq larg sa në disa vende të **Evropës** dhe **Amerikës Latine**, gjykatat kushtetuese janë shndërruar në forume për trajtimin e problemeve politike, sociale, ekonomike dhe kulturore, aq sa ato nganjëherë gjasojnë në parlamente apo qeveri nacionale.[93] Kjo, në literaturë, cilësohet si **ligjvënie pozitive** dhe është e kundërt me **ligjvënien negative**, të cilën **Hans Kelsen** dhe të tjerët e kanë parë si një nuzprodukt, si një domosdo, që i shkon vetë natyrës së gjyqësisë kushtetuese. Ky koncept, koncepti i **ligjvënësit negativ**, i referohet, siç e kemi vërejtur më herët, si normëvënies në materien legjislative ashtu edhe normëvënies në materien e amendamentimeve kushtetuese. Në këtë kapitull, thjeshtë, ne përdorim termin klasik të ligjvënies, si asaj pozitive ashtu dhe të asaj negative, ashtu siç është kuptuar ky term në kohën kur është farkuar ky term nga arkitekti ideor i gjyqësisë kushtetuese, **Hans Kelsen**.

Në rastin e **ligjvënies pozitive** nuk bëhet fjalë për një prodhim të domosdoshëm të gjyqësisë kushtetuese. I tillë është rasti, siç e pamë më herët, vetëm me **ligjvënien negative**. Kjo e fundit, **ligjvënia pozitive**, ndërkaq, nuk është nuzprodukt i domosdoshëm i aktivitetit të gjyqtarëve kushtetues por lind si rezultat i një aktiviteti të planifikuar dhe i vetëdijshëm të këtyre gjyqtarëve, të cilët uzurpojnë në mënyrë abuzive dhe të planifikuar prerogativat kushtetuese të ligjvënësit nacional. Kjo ligjvënie, thënë me fjalë të tjera, nuk rrjedh natyrshëm nga aktiviteti rutinë i gjyqësisë kushtetuese që ka për objekt të saj primar kontrollin abstrakt të normës juridike brenda parametrave të përcaktuar qartë me kushtetutë nacionale. Se kur bëhet fjalë për një **uzurpim**, ngelet të vlerësohet nga rasti në rast dhe nuk mund të jepet një udhëzim i përgjithshëm që të vlejë për të gjitha rastet, gjë që dëshmohet nga fakti se edhe vetë praktikat gjyqësore krahasimore ndryshojnë në këtë aspekt. Forma më drastike e aktivizmit gjyqësor që, në fakt, i ka dhënë kuptim pezhorativ aktivizmit gjyqësor asocohet pikërisht me fenomenin e **uzurpimit**, përkatësisht me fenomenin e ushtrimit pa të drejtë të funksioneve të pushtetit që u takojnë organeve apo institucioneve tjera.[94] Ekziston uzurpimi, përkatësisht **ligjvënia pozitive** atëherë kur gjykatat kushtetuese kryejnë ligjvënie, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, me rastin e vendosjes meritore të çështjeve të parashtruara pranë tyre për shqyrtim dhe vendosje dhe kjo ligjvënie konsiston në zëvendësimin (substituimin) e pikëpamjeve personale të gjyqtarëve kushtetuese me ato të ligjvënësit. E njëjta vlen, *mutatis mutandis*, edhe për kushte-

---

93 Në literaturë, si rasti i gjykatës aktiviste, zakonisht përmendet **Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë**, e cila në përvojën e saj të gjatë dhe të pasur ka krijuar praktika dhe standarde që dallon jashtë përfytyrimit origjinal të gjykatës kushtetuese të shfaqur nga **Hans Klesen**. Në lietarturë shkohet aq larg sa thuhet se kjo gjykatë është kthyer në burim kryesor të së drejtës. Cf. Juliano Zaiden Benvindo, *On the Limits of Constitutional Adjudication Deconstructing Balancing and Judicial Activism* (autori thekson **Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë** dhe **Gjykata Supreme Federale e Brazilit**, që është nën ndikim të madh të gjermanëve, nga një gjykatë aktiviste janë shndërruar në forume për trajtimin e problemeve sociale dhe politike); Sanita Osipova, "A State Governed by the Rule of law or "a Judges' State"? ", a paper presented at the international conference organized by the Constitutional Court of the Republic of Latvia in cooperation with European Commission for Democracy through law (Venice Commission) (26-27 May 2016, Riga), fq. 304-314 në fq. 307-308. Në internet: http://www.satv.tiesa.gov.lv/en/wp-content/uploads/sites/2/ 2017/06/ BookJudicial-activism-of-the-Constitutional-Court-in-a-Democratic State_ part _1 ENG.pdf (shikuar në shkurt 2019); Cf. po ashtu edhe Allan R. Brewer- Carias, *Constitutional Courts as Positive Legislators. A Comparative law Study* (Cambridge University Press: Cambrdige, 2011) (ku autori në pjesën e dytë të librit voluminoz afër njëmijë faqe jep në origjinal raportet nacionale të gjetjeve të hulumtimeve të kryera nga ekspertë vendorë të vendeve **latino-amerikane**, **evropiane**, **indiane** dhe **amerikane**; në veçanti shihet se në **Brazil, Kolumbi** dhe **Venezuelë** ekziston një përvojë e gjatë me aktivizëm, si në sferën e juridiksionit material ashtu edhe në sferën e juridiksionit procedural, duke shkuar aq larg sa të luajnë rolin e normëvënësit në çështje për të cilat asnjë gjykata kushtetuese nuk mund të ketë ekspertizë, si p.sh në çështjet sociale, ekonomike dhe në materiet tjera që kërkojnë legjitimitet të thellë demokratik; nga hulumtimet e këtij libri, ku përfshihen edhe gjykatat aktiviste evropiane, si ajo e Çekisë, **Hungarisë**, **Kroacisë** etj., del se ndikimi i **Gjykatës Kushtetuese Gjermane** në vendet e **Amerikës Latine** ka qenë jashtëzakonisht i madh, siç ka qenë edhe në **Spanjë** pas demokratizimit të saj në vitet '70 të shekullit të kaluar).

94 Lawrence A. Alexander, "Judicial Activism: Clearing the Air and the Head". Në Luís Pereira Coutinho, Massimo La Torre & Steven D. Smith (eds.), *Judicial Activism. An Interdisciplinary Approach to the American and European Experiences*, fq. 15-20 në fq. 16.

tutëvënien pozitive: në këtë rast, gjykatat kushtetuese uzurpojnë për veten e tyre prerogativat **e pushtetit konstituiv** (origjiner ose derivativ).

Në trajtimet tona përdorim fjalën ligjvënie, në ndërkohë që ky term nënkupton dhe përfshin edhe kushtetutëvënien, gjë që lexuesi mund ta kuptojë fare lehtë nga kontesti i fjalisë dhe mënyra e ndërtimit të saj. Emëruesi përbashkët i dyjave, ndërkaq, shprehet me fjalën **normëvënie**. Kjo këtu, megjithatë, nuk ka rëndësi për shkak se nga trajtimet tona lexuesi qartë e vëren së për cilën formë të aktivizmit gjyqësor bëhet fjalë. T'i kthehemi tani diskutimit aty ku ngelëm.

Nga hulumtimet empirike lidhur me **ligjvënien pozitive** janë vërejtur katër forma standarde të **uzurpimit** të pushtetit ligjvënës nga ana e gjykatave kushtetuese ose e organeve të tjera ekuivalente me to.[95] Kjo ligjvënie përfshin sferën e normave kushtetuese, normave ligjore e deri te ligjvënia në sferën që ka të bëjë me organizimin dhe funksionimin e brendshëm të gjykatave. Më konkretisht, katër format standarde të **ligjvënies pozitive** përfshijnë katër fushat për sa vijon:

- e para, normëvënia e gjykatave kushtetuese duke ndërhyrë në mënyrë të drejtpërdrejtë në prerogativat e sovranit ose përfaqësuesit të tij për ushtrimin e **pushtetit konstitutiv** (origjiner dhe derivativ), përmes krijimit të normave kushtetuese ose përmes mutacionit të kushtetutës ekzistuese (autori me këtë nënkupton vendimmarrjet e gjykatave kushtetuese që zgjidhin konfliktin për kompetencë duke krijuar norma të reja kushtetuese, vendimmarrjet që kanë të bëjnë me kontrollin kushtetues të amendamenteve dhe reformave kushtetuese duke folur në emër të sovranit dhe përfaqësuesit të tij dhe, në fund, vendimmarrjet me të cilat lejohet miratimi dhe ndryshimi i kushtetutës si në pjesën e lirive dhe të drejtave të njeriut ashtu edhe në pjesën institucionale; sipas autorit, në rastet e fundit, çështja fundamentale që shtrohet, ka të bëjë me legjitimitetin e gjykatave kushtetuese për të bërë mutacionet kushtetuese përmes vendimmarrjes, në emër të kontrollit të kushtetutshmërisë).[96]

- e dyta, normëvënia e gjykatave kushtetuese në legjislacionin parlamentar duke luajtur rolin e ndihmësit të ligjvënësit përmes plotësimit të ligjeve me futjen (shtimin) e normave të reja dhe përcaktimin e efekteve kohore të vlefshmërisë së legjislacionit (autori me këtë nënkupton vendimmarrjet që interpretojnë ligjet në harmoni me kushtetutën, vendimmarrjet me të cilat futen rregulla të reja ligjore apo kuptime të ndryshme të reja në legjislacionin ekzistues, vendimmarrjet me të cilat ndikohet ne efektet kohore të zbatimit të legjislacionit ekzistues, gjë që paraqet plotësim të këtij legjislacioni).[97]

- e treta, normavënia e gjykatave kushtetuese në mungesë të veprimit legjislativ të ligjvënësit nacional (**ometimi legjislativ**), duke shërbyer herë – herë edhe si ligjvënës të përkohshëm (autori me këtë nënkupton vendimmarrjet e gjykatave kushtetuese me qëllim të plotësimit të vakumit legjislativ të krijuar si pasojë e mosveprimit apo ometimit)[98] dhe, së fundi,

- e katërta, normëvënia e gjykatave kushtetuese në sferën e kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë (autori me këtë nënkupton vendimmarrjet e gjykatave kushtetuese,

---

[95] Në një studim voluminoz mijëra faqesh, më i miri dhe më i ploti deri më sot lidhur me pozitën dhe rolin e gjykatave kushtetuese në sferën e normëvënies, autori i mirënjohur, **Alan R. Brewer – Carias**, ka dhënë katër fusha ku gjykata kushtetuese ngjasojnë me **ligjvënësin pozitiv**, përkatësisht me normëvënësit pozitiv në rendin kushtetues nacional. Cf. Allan R. Brewer – Carias, *Constitutional Courts as Positive Legsialtor. A Comparative Legal Study*, fq. 41-191.

[96] Ibid. fq. 41-72.

[97] Ibid. fq. 13-40.

[98] Ibid. fq. 125-171.

të cilat krijojnë juridiksion dhe procedural material për dobi të tyre, përkatësisht vendimmarrjet përmes të cilave gjykatat kushtetuese zgjerojnë juridiksionin e tyre material dhe procedural për vendimmarrje).[99]

Përveç formës së ligjvënies në sferën që ka të bëj me organizimin dhe funksionimin e brendshëm të gjykatave, tri format e para standarde të ligjvënies pozitive të përshkruara si më sipër diskutohen në seksionin 15.2 të kapitullit pesëmbëdhjetë, ku flitet për efektet juridike të vendimeve të gjykatave kushtetuese dhe mënyrën e menaxhimit të tyre. Në përpjekjet e gjykatave kushtetuese për menaxhim të efekteve juridike të vendimeve të tyre kanë lindur të tri format standarde të aktivizmit gjyqësor që u përshkruan më sipër. Në veçanti aspekti kohor i efekteve juridike ka prodhuar aktivizëm gjyqësor, por edhe menaxhimi i caqeve materiale të efekteve juridike të vendimeve të gjykatave kushtetuese kanë qenë faktor që kanë çuar në aktivizëm. Të gjitha këto aspekte lexuesi i gjen të shtjelluara në kapitullin në vijim, në seksionin e cekur si më sipër.

Si formë tjetër, po ashtu drastike drastike, e kundërt me **ligjvënien pozitive**, por që lidhet me fenomenin e aktivizmit gjyqësor, është **abstenimi** apo **pasiviteti gjyqësor**: në këtë rast, përmes përdorimit të arsyetimeve të ndryshme, gjykatat kushtetuese refuzojnë të pranojnë për shqyrtim dhe vendosje një çështje, përkatësisht të zgjidhin një mosmarrëveshje kushtetuese.[100] Kjo situatë, duhet të bëhet e qartë këtu, ekziston si mundësi jo vetëm në **SHBA**, ku edhe ka lindur, por edhe në vendet tjera të sistemit të së **drejtës së përgjithshme**. Në sistemin **evropian/kelsenian** të gjyqësisë kushtetuese, ku ekziston një gjykatë me juridiksion të qartë dhe të ndarë kushtetues, një abstenim apo pasivitet gjyqësor nuk mund dhe nuk duhet të ekzistojë. Kjo është kështu, në parim, nisur nga fakti se këto gjykata nuk kanë diskrecion për të vendosur se cilat raste janë të lejueshme për gjykim dhe vendosje e cilat nuk janë. Thënë me fjalë të tjera, në sistemin **evropian/kelsenian** të gjyqësisë kushtetuese juridiksioni i paracaktuar kushtetues i gjykatave kushtetuese nuk përfshinë të

---

99 Ibid.fq. 173-188.

100 Në këto situata, në fakt, fjala është për plotësimin e disa prezumimeve procedurale për lejueshmërinë e shqyrtimit dhe vendosjes lidhur me një çështje kushtetuese apo zgjidhje të një mosmarrëveshjeje që ka natyrë kushtetuese. Kjo nënkupton se, në thelb, plotësimi i tyre realizon të njëjtin funksion që kanë prezumimet në modelin **evropian/kelsenian** të gjyqësisë kushtetuese, me një dallim: në ndërkohë që në këtë të fundit, gjykata kushtetuese zakonisht nuk ka diskrecion për të vendosur lidhur me marrjen e një çështjeje kushtetuese në konsideratë, në të parin ekziston një diskrecion i plotë i gjykatës kushtetuese, përkatësisht i gjykatës më të lartë në vend që ushtron funksione të gjykatës kushtetuese, si p.sh. Gjykata Supreme e SHBA, për të vendosur lidhur me atë se cilat çështje apo mosmarrëveshje kushtetuese do të dalin para saj për shqyrtim dhe vendosje. Kështu është edhe në vendet tjera të sistemit të së **drejtës së përgjithshme**.
Si **prezumime procedurale** për vendosje (në fakt këtu nuk bëhet fjalë për **prezumime procedurale** në kuptimin kontinental, por për prezumime që kanë të bëjnë me **vlerësimin e përshtatshmërisë së rastit apo mosmarrëveshjes për t'u gjykuar apo zgjidhur me mjete gjyqësore**), në kuadër të diskrecionit të gjykatës më të lartë në vendet e sistemit të së **drejtës së përgjithshme**, të cilat janë ekuivalente me gjykata kushtetuese të sistemit kontinental, zakonisht paraqiten rrethanat që kanë të bëjnë me si vijon:
a). objektin e kërkesës (kërkesa nuk duhet të konsistojë në kërkimin e një mendimi këshillëdhënës nga gjykata, por me vendosjen për një rast apo mosmarrëveshje kushtetuese);
b). çështja që gjykohet apo mosmarrëveshja që duhet të zgjidhet nga gjykata nuk duhet të jetë a papjekur (e parakohshme) apo e pa objekt (e zgjidhur nga vetë palët ose nga kalimi i kohës); dhe
c). çështja apo mosmarrëveshja nuk duhet të kenë natyrë politike, përkatësisht duhet të jenë të përshtatshme për vendosjes apo zgjidhje me mjete juridiko-gjyqësore. Cf. më shumë për përvojën amerikane dhe përvojën e disa vendeve të tjera të sistemit të së **drejtës së përgjithshme**, në Ariel L. Bendor, "Are There Any Limits to Justiciability? The Jurisprudencial and Constitutional Controversy in Light of the Israeli and American Experience". *Indiana International & Comparative law Review* Vol. 7 No. 2 (1997) fq. 311-377; Paul Anthony McDermott, "The Separation of Powers and the Doctrine of Non-Justiciability". *The Irish Jurist* New Series, Vol. 35 (2000) fq. 280-304; Jeffrey Usman, "Non-Justiciable Directive Principles: A Constitutional Design Defect". *Michigan State Journal of International law* Vol. 15 Issue 3 (2007) fq. 643-697; Joanne Banker Hames and Yvonne Ekern, *Constitutional law: Principles and Practice*. Second Edition (CENGAGE Learning, Delmare: USA, 2012), fq. 61-69 (ku autori diskuton për **urdhrin e certifikimit** në praktikën gjyqësore të **Gjykatës Supreme të SHBA**, i njohur si **writ of certiorari** ose **cert**, si dhe kriteret që një rast apo mosmarrëveshje duhet t'i plotësojë për t'u quajtur si i përshtatshëm për gjykim dhe vendosje; ato kritere janë: që të ekzistoj një rast ose mosmarrëveshje reale, jo për një kërkesë për vendim këshillues; që ajo të jetë e pjekur me kohë për vendosje dhe zgjidhje; që palët të kenë cilësinë e palëve; dhe, në fund, mos të bëhet fjalë për një çështje politike).

drejtën e tyre për vendosje në mënyrë diskrecionale lidhur me rastet apo mosmarrëveshjet që i pranojnë për shqyrtim dhe vendosje meritore.[101] Për të qenë i lejueshëm një rast për gjykim dhe vendosje, çdoherë duhet të ekzistojë një arsyetim juridik, i bazuar në parametra kushtetues, ligjor dhe parametra të tjerë të përcaktuar me rregullat e brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e gjykatës kushtetuese **evropiane/kelsenian**. Në sistemet tjera të vendeve të së **drejtës së përgjithshme**, gjykatat kanë diskrecion që as mos të regjistrojnë fare rastet e paraqitura në listën e rasteve që duhen vendosur apo mosmarrëveshjeve që duhen zgjidhur, pa dhënë arsye me shkrim për një veprim të tillë.

Fare në fund të këtij seksioni diskutojmë **faktorët ambientalë** (**rrethanorë**) si shkak për aktivizëm gjyqësor. Këta faktorë kanë të bëjnë me **shoqëritë post-revolucionare** apo me **shoqëritë në trancizion**, të cilat kanë kaluar një fazë të dhunshme apo një periudhë të turbullt shoqërore të përmbysjes dhe ndryshimit të vlerave të caktuara. Në situatat e tilla, gjyqësia kushtetuese luan një rol të madh sepse krejt përpjekjet koncentrohen në vënie të drejtësisë, jo aq sa për të ndërtuar një sundim real të ligjit. Në **vendet ish-komuniste**, por edhe në vendet e Evropës Jugore që kanë kaluar nëpër diktaturat e djathta në mesin e viteve ’70 të shekullit të kaluar (**Spanja**, **Portugalia** dhe **Greqia**), gjyqësia kushtetuese ka pasur rol primar në tejkalimin e fazës post-konfliktuale të këtyre vendeve. Në sferën e **pronësisë** dhe të **privatizimit**, ta zëmë, këto vende ndërtuan infrastrukturë ligjore për restituimin dhe kompensimin e ish-pronarëve që pak kishin të bënin me sundimin e ligjit: qasjet dhe infrastruktura juridiko-politike dhe institucionale që u ndërtuan më shumë synonin arritjen e një drejtësie sociale për viktimat e diktaturës dhe dhunës së mëhershme shtetërore se sa një sundim të mirëfilltë të ligjit. Njëjtë ishte situata edhe më të a.q. **ligjet për lustrimin** që ishin nxjerrë nëpër vendet ish-komuniste, me të cilat synohej restaurimi i dinjitetit të viktimave të dhunës komuniste. Edhe në këto raste shumë pak bëhej fjalë për qasje që respekton liritë dhe të drejtat e viktimizuesve. Në këso atmosfere të rënduar, gjykatat kushtetuese kanë luajtur rolin e tyre aktivist me qëllim mbrojtjen e **supremacisë** (**epërsisë**) së kushtetutave të reja të ish-komuniste. Këto kushtetuta ishin prodhime të tranzicionit dhe, në të njëjtën kohë, ato vetë duhej të shërbenin si instrumente të ndryshimit dhe tejkalimit të tranzicionit post-komunist. Më një fjalë, kushtetutat e reja ishin jo vetëm instrumente të normimit të jetës sipas parimit kushtetues mbi sigurinë dhe barazinë juridike, por ato shërbenin edhe si një kuadër juridik për ofrim drejtësisë për viktimat e terrorit dhe dhunës komuniste.

Situatë e ngjashme me vendet ish-komuniste ka qenë me **Austrinë, Gjermaninë** dhe **Italinë** pas **Luftës së Dytë Botërore**. Në një situatë të tillë, gjykatat kushtetuese të këtyre vendeve ishin pjesë e ndryshimit dhe duhej të shërbenin si instrumente të vënies në jetë të vlerave, normave dhe parimeve të reja kushtetuese që mëtonin shërimin e të kaluarës së dhunshme dhe kalimin në shoqëri normale ku sundon kushtetuta e ligji. Në këtë drejtim, dispozitat mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, të futura nëpër në kushtetutat e reja të vendeve që kishin dalë nga dhuna (komuniste ose nazi-fashiste), shërbenin si një spirancë në të cilën ankorohej aktivizimi i gjykatave të reja kushtetuese, mision primar i të cilave ishte të ndihmonin transformimin e shpejtë të shoqërive post-violente në shoqëri që të funksionojnë sipas kushtetutës dhe ligjeve bashkëkohore të sistemeve të reja kushtetuese liberale. Ky korpus i lirive dhe të drejtave të njeriut kishte një status

[101] Luís Pereira Coutinho, “The Passive Sovereignty of the Constitutional Judge a State Theory Approach”. Në Luís Pereira Coutinho, Massimo La Torre & Steven D. Smith (eds.), *Judicial Activism. An Interdisciplinary Approach to the American and European Experiences*, fq. 119-133 (autori thot se kushtetutat janë të mira për rrethanat normale, njëjtë siç kishte pleduar **Karl Shmit**, idetë e të cilit gjerësisht i përdor si argument; në rrethana të jashtëzakonshme dhe jonormale ato mund të prodhojnë rezultate jo fort të mira, konstaton ky autor; për këtë arsye, autori mendon se gjykatat kushtetuese mund të luajnë një rol heterodoks: në kushtet normale, ato luajnë rolin e gjykatave kushtetuese sipas parametrave mbi sundimin e ligjit dhe të kushtetutshmërisë, por në gjendjen e jashtëzakonshme ato duhet të ngelin akterë pasivë dhe të lejojnë dominimin e drejtës politike, jo të sundimit të ligjit; si shembull për këtë, autori e merr **Senatin e Romës**, i cili kishte të drejtën e vlerësimit të rrethanave të jashtëzakonshme, por jo edhe të drejtën për të pasur rol aktiv në zgjidhjen e gjendjes së tillë; kjo nënkupton, gjithnjë sipas tij, se gjykatat kushtetuese mund të veprojnë si sovran pasiv sepse vlerësojnë kushtet e ekzistimit dhe zgjatjes së gjendjes së jashtëzakonshme duke ia njohur shtetit të drejtën për të vepruar politikisht në një gjendje të tillë, pra duke përdorur mjete politike me qëllim të përballimit të gjendjes në fjalë).

të fuqishëm normativ brenda rendit të ri juridiko-kushtetues që u ndërtua nëpër këto vende. Për dallim nga e kaluara, tani liritë dhe të drejtat e njeriut ishin vënë në tekstet kushtetuese me qëllim të vënies së tyre në jetë dhe për të shërbyerë si levë për kufizim të pushtetit politik.

Sistemi i lirive dhe të drejtave njerëzore sanksionohet me kushtetutat nacionale të vendeve demokratike në dy anët e **Atlantikut** dhe përbën një rend objektiv total juridik. Kjo nënkupton se drejtat dhe liritë e njeriut nuk janë më çështje programore, si dikur, por janë të sanksionuara me kushtetutë si të drejta dhe liri subjektive me fuqi më të lartë juridiko-normative, të mbarështuara në tekstin kushtetues me qëllim të zgjidhjes së problemeve të tanishme dhe të ardhshme të shoqërisë. Për pasojë, vënia e tyre në jetë duhet të bëhet përmes një mekanizmi të caktuar gjyqësor, mekanizimit të gjykatave kushtetuese në rend të parë, gjë që nënkupton se ky rend objektiv i nënshtrohet një interpretimi përmes **operacionit silogjistik** (**mendor/intelektual**) të gjyqtarëve (atyre kushtetues në rend të parë), për t'i orientuar këto liri dhe të drejta kah realizimi i rendit të ri objektiv kushtetues. Ky proces interpretimi është shumë i vështirë sepse duhet të krahasohen liritë dhe të drejtat e njeriut, **si të drejta subjektive të pranuara nga rendi objektiv juridik-kushtetues,** me situata faktike jetësore të cilat nuk u përshtaten standardeve të reja kushtetuese. Kjo ka kërkuar një balancim të kujdesshëm në mes të vlerave dhe interesave që mishërohen në liritë dhe të drejtat konkrete të njeriut me vlerat dhe interesat e shoqërisë marrë si tërësi. Interesat dhe vlerat e shoqërisë, ndërkaq, janë më të ndryshme se përcaktimet kushtetuese dhe parametrat kushtetues që duhen vënë në jetë në sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Procesi i balancimit, si pjesë e këtij procesit interpretues të lirive dhe të drejtave kushtetuese të individëve me rastin e gjykimit dhe vendosjes lidhur me to, paraqet një teknikë përmes së cilës gjyqtarët përpiqen të arsyetojnë në aspektin metodologjik karakterin jo-politik të gjykimit kushtetues. Kjo, në të njëjtën kohë, nënkupton se balancimi domosdo shërben si një instrument i përshtatshëm për të racionalizuar natyrën aktiviste të gjykatave kushtetuese. Kjo nuk nënkupton që balancimi gjyqësor i lirive dhe të drejtave të njeriut, që janë në konflikt me njëra tjetrën dhe potencialisht përjashtohen ndërmjet veti me rastin e gjykimit mbi to, përbën një rrezik për mbrojtjen dhe promovimin e tyre. Përkundrazi, balancimi shërben si një mjet që i mbron dhe i promovon të njëjtat sepse ai duhet të kryhet çdoherë brenda parametrave ekzistues kushtetues. Kjo më së miri shihet nga praktika gjyqësore e **Gjykatës së Strasburgut**, aty ku ka lindur vetë ideja e balancimit gjyqësor me rastin e vendosjes për liritë dhe të drejtat e njeriut të garantuara me **KEDNJ**. Kjo praktikë përbën një pikë të fortë referimi jo vetëm për Kosovën por edhe për tërë botën ish-komuniste dhe, nëse shikohet në retrospektivë, ka shërbyer si një udhëzues për vendet e demokracive tradicionale evropiane që kanë kaluar diktaturat e ndryshme gjatë dhe pas **Luftës së Dytë Botërore**.

Të kuptuara si më sipër, jo si qëllime programatike dhe ideore, por si pjesë e një **rendi objektiv juridik - kushtetues**, liritë dhe të drejtat e njeriut përbëjnë një sistem që supozon ekzistimin e një mekanizmi për vënien e tyre në jetë në mënyrë efektive dhe efikase, si dhe ekzistimin e një kontrolli mbi këtë implementim. Ky kontroll implementues i mekanizimit për vënien në jetë të lirive dhe të drejtave të njeriut mund të jetë i nivelit regjional dhe ndërkombëtar. Në nivel evropian, i tillë është, pra si faktor i fuqishëm mbikëqyrës i këtij implementimi, **GJEDNJ** dhe instrumenti juridik të cilin ajo e interpreton, **KEDNJ.** Status të ngjashëm gjetiu ka edhe **Gjykata Ndëramerikane mbi të Drejtat e Njeriut** (GJNDN). Në nivel ndërkombëtar, ndërkaq, si të ngjashme me si më sipër janë trupat kontraktuale të dy pakteve mbi të drejtat e njeriut të vitit 1996 dhe shumë konventa e traktate tjera që kanë në gjirin e tyre mekanizma implementues të detyrimeve të shteteve të veta anëtare. Ne këtu na intereson vetëm niveli regjional evropian, në dritën e **aktivizmit gjyqësor**, për shkak se në Kosovë standardet dhe praktika gjyqësore e **Gjykatës së Strasburgut** përbën një detyrim kushtetues, siç përbën detyrim kushtetues vënia në jetë në mënyrë të drejtpërdrejtë e dispozitave të **KEDNJ**, e cila ka status të normës kushtetuese kosovare.

E parë nga ky këndvështrim, në sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut, aktivizmi gjyqësor evropian ka qenë shumë më pak i theksuar si pasojë e ekzistimit të **KEDNJ** dhe interpretimit të saj relativisht uniform në truallin e shumicës së vendeve të kontinentit të vjetër. **GJEDNJ** kujdeset për zbatimin uniform të **KEDNJ**, në mënyrë analoge siç kujdesen gjykatat supreme apo gjykatat kushtetuese në nivel

nacional për zbatimin uniform të kushtetutës. Në fakt, **GJEDNJ** përbën një qendër nervore për vënien e standardeve juridike të përbashkëta për mbrojtjen dhe interpretimin e të drejtave të njeriut.[102] Në vendet tjera të demokracive perëndimore, si p.sh. në **SHBA**, nuk merret si **aktivizëm gjyqësor** gjykimi dhe verdikti i shprehur në lëmin e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut të garantuara me kushtetutë. Në lëmin e tillë, në fakt, ai inkurajohet.[103] Arsyeja kryesore për aktivizëm gjyqësor, si në **Evropë** ashtu edhe në **SHBA**, megjithatë, është e njëjtë: si në rastin evropian, ku aktivizmi në sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut nuk inkurajohet, ashtu edhe në atë amerikan ku një gjë e tillë inkurajohet, arsyeja për aktivizëm ka karakter objektiv dhe lidhet me faktin që liritë dhe të drejtat e njeriut kanë karakter të së drejtës objektive, e cila e drejtë ka një sanksion dhe mekanizëm për zbatim në rast të mosvënies së tyre në jetë në mënyrë vullnetare. Të shohim nga afër si duket kjo në **Evropë** dhe cilat janë teknikat dhe metodologjitë e interpretimit të korpusit të lirive dhe të drejtave të njeriut si e drejtë objektive. Për **sistemin amerikan** nuk flasim dhe udhëzojmë lexuesin që për një gjë të tillë të konsultojnë leximin shtesë, të dhënë në fund të këtij kapitulli dhe të secilit prej kapitujve të tjerë të këtij libri.

Krahas arsyes bazike si më sipër, në literaturë është vërejtur se, në veçanti në Evropë, ekzistojnë edhe disa arsye të tjera që mbështesin aktivizmin gjyqësor në sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut.

E para ndër to lidhet me cilësinë e normëvënies: arsyeja për një aktivizim të gjykatave nacionale në Evropë shpesh herë qëndron në faktin se normëvënia në këto vende ka qenë shumë e ngadaltë në ato sfera ku nuk ekziston një konsensus në nivel evropian. Janë disa liri dhe të drejta të njeriut rreth të cilave në nivel evropian nuk ka një konsensus për dekada të tëra. Në këto raste, intensiteti i kontrollit që ushtrohet nga **Gjykata e Strasburgut** duhet të jetë minimal për arsye të mungesës së këtij konsensusi duke ua lënë shteteve anëtare lirinë e vlerësimit të lirë dhe në respektim të specifikave nacionale të secilit vend. Të tilla sfera janë, ta zëmë, aborti, liritë e caktuara fetare, etj. Në këtë sferë ekziston parimi i vlerësimit të lirë (**margin of appreciation**), ashtu që parimi i proporcionalitetit si një korrektues i këtij vlerësimi në nivel nacional gjykohet duke marr parasysh dallimet kulturore dhe dallimet tjera ndërmjet shteteve.[104]

Në vijim si më sipër, një arsye tjetër për aktivizim gjyqësor po ashtu mund të jetë edhe situata e kundërt me atë si më sipër (kur nuk mungon konsensusi ndërmjet vendeve anëtare të **KEDNJ):** në rastet kur ka konsensus të plotë rreth disa vlerave që i mbron **KEDNJ,** si psh. **e drejta për jetë**, **ndalimi i torturës**, **dinjiteti i njeriut** etj., atëherë aktivizmi në nivel nacional mund të rrjedh si pasojë e veprimit të ngadalshëm të ligjvënësit nacional për të ndryshuar situatën e konstatuar në nivel evropian në mënyrë konsensuale. Mjafton të theksohet me këtë rast se, ta zëmë, dënimi me vdekje në shumicën e vende evropiane dhe më gjerë është hequr me vendim gjyqësor, jo më normëvënie. Kjo e fundit ka pasuar shumë më vonë se heqja e dënimit me vdekje me vendim gjyqësor. Në fakt, edhe gjetiu nëpër botë mund të vërehet se për çështje të ndjeshme, si p.sh., **e drejta e martesës në mes të sekseve të njëjta**, kanë qenë gjykatat kushtetuese ato që kanë prirë në promovimin dhe mbrojtjen e tyre.[105]

Aty ku ka pasur më shumë **aktivizim gjyqësor**, qoftë si pasojë e ekzistimit të konsensusit apo e mungesës së tij rreth disa lirive dhe të drejtave njerëzore, ai ka pasur të bëjë kryesisht me situatat kur gjykatat kushtetuese, sikundër edhe vetë **Gjykata e Strasburgut**, kanë qenë të detyruara që të bëjnë balancimin dhe zgjidhjen në mes dy të drejtave apo të dy interesave në konflikt, për të gjetur në fund një **via media** që akomodon esencën e lirisë apo të drejtës përkatëse. Të tilla janë, ta zëmë, **rastet e abortit**, **martesat në mes të sekseve të njëjta**, **dënimi me vdekje**, **liritë fetare** (siç është, ta zëmë, rasti i bartjes së simboleve fetare nëpër shkolla dhe hapësira tjera publike) dhe kështu me radhë. Kjo hapësirë apo ky kuadër i vendimmarrjes që krijon mundësitë reale për një mënyrë aktiviste në vendimmarrjet e gjykat-

[102] Paul L. McKaskle, "The European Court of Human Rights: What It Is, How It Works, and Its Future" fq. 42-43.

[103] Keenan D. Kmiec, "The Origin and Current Meanings of Judicial Activism", fq. 1451.

[104] Maria Lúcia Amaral, "Judicial Activism of European Constitutional Courts: does it really exist?", fq. 341.

[105] David KC Huan, "The Court and the Legislation of Same Sex Marriage: A Critical Analysis of the Judicial Yuan Interpretation No. 748 [2017]. *University of Pennsylvania Asian law Review* Vol. 14 No. 1(2019).

ave kushtetuese, për shkak të rrethanave objektive si më sipër (mungesës së konsensusit apo ekzistimit të tij në nivel evropian rreth disa lirive dhe të drejtave të garantuara me **KEDNJ**), ndryshe njihet edhe si doktrina e vlerësimit të lirë (**marigin of appreciation)**. Si e tillë, ajo çdoherë zbatohet në nivel nacional dhe evropian kur duhet të balancohen interesat dhe të drejtat që janë në konflikt reciprok dhe që potencialisht përjashtojnë njëra tjetrën.

E parë me sytë e **Gjykatës së Strasburgut**, vlerësimi i lirë nuk paraqet një koncesion evropian ndaj juridiksioneve nacionale në sferën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut. Ajo, në thelb, paraqet një produkt të domosdoshëm që rrjedh nga vënia në jetë e parimit të subsidiaritetit të **Strasburgut** kundrejt gjykatave nacionale të instancës së fundit që gjykojnë lidhur me liritë dhe të drejtat e njeriut. Kjo është kështu për shkak se, nënkuptohet, autoritetet vendore të vendeve palë në **KEDNJ**, si shtete sovrane dhe të pavarura, duhet të kenë një hapësirë manovrimi me rastin e interpretimit të lirive dhe të drejtave të garantuara me te.[106] Në këtë kuptim, gjykatat kushtetuese kanë imituar dhe imitojnë **Strasburgun** dhe kanë luajtur një rol historik prijës në kuptimin e plotë të fjalës në ato sfera ku nuk ka ekzistuar një konsensus nacional lidhur me disa liri dhe të drejta njerëzore, për shkak se kanë pasur **ngarkesa të theksuara morale dhe etike**, siç janë, fjala vjen, çështja e abortit, liritë fetare, liria e shprehjes dhe kështu me radhë.[107] Dhe, anasjelltas, kur ka pasur një konsensus në nivel evropian, por normëvënia në sferat e tilla konsensuale ka munguar për një kohë të gjatë për shkak të neglizhencës së faktorëve politik, gjykatat kushtetuese kanë çarë *rrugën* duke vepruar sipas standardeve të **Gjykatës së Strasburgut**.

Në vijim të zbatimit të parimit të subsidiaritetit, **Gjykata e Strasburgut** vlerëson dhe, në vartësi të rastit, korrigjon ose përligjëson analizën e dhënë në vendimet e gjykatave nacionale rreth mënyrës së zbatimit të **parimit të proporcionalitetit**. Ky parim shërben si një pengesë e fortë kundër shpërdorimit të vlerësimit të lirë nga ana e gjykatave nacionale: mosrespektimi i parimit të proporcionalitetit me rastin e kryerjes së vlerësimit të lirë mund të çoj në humbjen e përfitimit që sjell me vete vlerësimi i lirë nga ana e shtetit përkatës. Kjo është kështu sepse parimi i proporcionlitetit është i lidhur ngushtë me parimin e mbrojtjes efektive të lirive dhe të drejtave të njeriut: nëse vlerësimi i lirë shpërdorohet, atëherë zbulohet se, në fakt, ai paraqet hapësirën e lirë brenda së cilës shtetet kanë bërë gabimet e tyre gjatë interpretimit të lirive dhe të drejtave të garantuara me **KEDNJ**. Këto gabime njihen si vlerësim i gabuar (**margin of error**). **Gjykata në Strasburg** e bën vlerësimin me qëllim të konstatimit nëse gjykata respektive nacionale është futur në vlerësim të gabuar me rastin e kryerjes së vlerësimit të lirë. Në rastet kur bëhet fjalë për vlera e parime të **KEDNJ** që kanë natyrë absolute, siç është jeta dhe dinjiteti njerëzor, **Strasburgu** nuk lejon që në emër të lirisë së vlerësimit të shpërfytyrohet parimi korrektues i proporcionalitetit. Kështu, ta zëmë, në rastin e të drejtave të homoseksualëve, në kuadër të mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, **Gjykata në Strasburg** nuk ka lejuar që të kufizohen të drejtat e tyre në emër ekzistimit të "një interesi madhor shtetëror" në një "shoqëri demokratike". Kjo për shkak se një kufizim i tillë bie ndesh me jetën dhe dinjitetin e njeriut si vlera absolute sublime.[108]

---

[106] Paul L. McKaskle, "The European Court of Human Rights: What It Is, How It Works, and Its Future", fq. 49-51.

[107] Në praktikën gjyqësore të **Gjykatës së Strasburgut** janë krijuar disa parime udhëheqëse lidhur me zbatimin e doktrinës së vlerësimit të lirë (**margin of appreciation).** Ato janë si vijon:
a). në rastet kur bëhet fjalë për segmente të veçanta të ekzistencës apo identitetit të individit, atëherë liria e vlerësimit të lirë (**marign of appreciation**) është mjaft e ngushtë;
b). në rastet kur nuk ka konsensus në mes të vendeve evropianë sa i përket interesave që janë në konflikt si dhe sa i përket mënyrës më të mirë por mbrojtjen e interesave të tilla, dhe në veçanti kur bëhet fjalë për çështje të ndjeshme morale dhe etike, atëherë liria e vlerësimit të lirë (**marign of appreciation**) është mjaft e gjerë; dhe, së fundi,
c). në rastet kur nga shteti kërkohet që të balancoj interesat private me ato publike, atëherë liria e vlerësimit të lirë (**marign of appreciation**) do të jetë edhe më e gjerë. Cf. Dean Spielmann, "Unravelling the Myth of Judicial Activism through Dialogue with National Courts: The Strasbourg Experience", a paper presented at the international conference organized by the Constitutional Court of the Republic of Latvia in cooperation with European Commission for Democracy through law (Venice Commission) (26-27 May 2016, Riga), fq. 324-336 në fq. 327. Në internet: http:// www.satv.tiesa.gov.lv/en/wp-content/uploads/sites/2/2017/06/BookJudicial-activism-of- the-Constitutional Court-in-a-Democratic State_ part _1 ENG.pdf (shikuar në shkurt 2019).

[108] Paul L. McKaskle, "The European Court of Human Rights: What It Is, How It Works, and Its Future", fq. 48.

Në sferën e normëvënies (kushtetutëvënies dhe ligjvënies), sikundër u sqarua më sipër, aktivizmi gjyqësor asocohet me **abdikim të pushteit** nga njëri organ kushtetues dhe me **uzurpim** të të njëjtit nga ana e gjykatave dhe pushtetit gjyqësor, përfshirë këtu gjykatat dhe gjyqësinë kushtetuese të modelit evropian/kelsenian. Në këtë rast nuk bëhet fjalë për kultivim të **parimit të proporcionalitetit**, përkatësisht balancim të dy vlerave dhe interesave me qëllim të gjetjes së vlerës apo interesit më të madh kundrejt një vlere apo interesi tjetër të garantuar me kushtetutë nacionale. Në rastin e abdikimit të pushtetit, si rezultat i aminimit dhe tolerimit të uzurpimit të tij nga ana e gjykatës kushtetuese, aktivizmi gjyqësor prish parametrat që mundësojnë ruajtjen dhe kultivimin e parimit kushtetues të **ndarjes dhe balancimit të pushtetit**. Kjo në rend të parë nënkupton që, në rastet e uzurpimit të pushtetit, nuk respektohet premisa themelore kushtetuese që përcakton se secili pushtetet duhet të veprojë brenda kufijve të përcaktuar me kushtetutë nacionale. E njëjta vlen edhe për abdikimin: asnjë pushtet kushtetues nuk duhet të abdikojë nga ushtrimi i kompetencave kushtetuese në favor të organit apo institucionit tjetër dhe këtë duhet ta ketë parasysh gjykata kushtetuese kur vendos rastet e abdikimit. Në këtë aspekt, shumë domethënës është vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në rastin e dialogut me Serbinë, jo pse ka ushtruar aktivizëm gjyqësor por sepse ka shpallur si jo kushtetues delegimin nga Qeveria e Kosovës të kompetencave kushtetuese për dialogim te një organ tjetër.[109] Po ashtu, në sferën e konfliktit për kompetencë, ekziston një vendim i rëndësishëm i Gjykatës Kushtetuese për një rast që, në fakt, nuk ka qenë konflikt për kompetencë. Ai ka qenë i tillë vetëm fiktivisht sepse në thelb ka pasur të bëj me tentim për krijim fals të konfliktit për kompetencë nga ana e Presidentit të Republikës, me qëllim të uzurpimit të kompetencave për lidhje të marrëveshjeve ndërkombëtare nga neni 18.1 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] i Kushtetutës, prerogativë kjo e Kuvendit, jo e Presidentit të Republikës.[110]

Edhe në gjykimin e rasteve të tilla ndodhë, në instancë të fundit, sigurimi i mbrojtjes së lirive dhe të drejtave njerëzore. Mbrojtja e tillë vjen si rezultat i zbatimit **silogjizmit gjyqësor**, pjesë e të cilit është **parmi i proporcionalitetit**, ku gjykatat kushtetuese bëjnë vlerësimin me qëllim të gjetjes së preponderancës më të fortë të njërës prej tyre, duke deklaruar si kushtetues atë normëvënie (kushtetutëvënie dhe ligjvënie) që ka për qëllim ndërtimin e një rendi objektiv juridik ku liritë dhe të drejtat e njeriut janë pjesë përbërëse e tij, si në aspektin **vertikal** (raporti i individit me shtetin) ashtu edhe në aspektin **horizontal** (raporti i individëve ndërmjet veti), i njohur ndryshe edhe si efekti horizontal i të lirive dhe të drejtave kushtetuese.

Jashtë këtyre dy hapësirave si më sipër brenda të cilave zakonisht ndodhë, **grosso modo**, **aktivizmi gjyqësor** i gjykatave kushtetuese apo i gjykatave të barasfvleshme me to, ekzistojnë edhe sfera të tjera të gjykimit kushtetues në të cilat aktivizmi gjyqësor është prezent. Edhe këtu **aktivizmi gjyqësor** ndodhë në lëmin e organizimit të pushtetit shtetëror dhe mënyrës së ushtrimit të tij, mirëpo këtë herë jashtë sferës së normëvënies (kushtetutëvënies dhe ligjvënies). Në këtë kontekst, përveç rastit të normëvënies (kushtetutëvënies dhe ligjvënies), i diskutuar si më sipër, si sferë e kompetencave **ratione materiae** të gjykatave kushtetuese, në lëmin e balancimit dhe ndarjes së pushteteve, konsiderohet edhe juridiksioni që ka të bëjë me **konfliktin për kompetencë**, normëvënien në lëmin e **vetëqeverisjes lokale**, normëvënien në lëmin e **referendumit nacional** dhe formave të tjera të shprehjes së drejtpërdrejtë të vullnetit, në lëmin e **organizimit politik në parti politike** dhe forma të tjera të organizimit dhe kështu me radhe. Kjo nënkupton që, thënë ndryshe, përveç në lëmin e mbrojtjes së **parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve**, me qëllim të mbrojtjes dhe sigurimit të supremacisë (epërsisë) së drejtpërdrejtë të kushtetutës, si dhe në lëmin e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave kushtetuese, të përshkruara si më sipër, sferat tjera në të cilën gjykatat kushtetuese janë parë si aktiviste, ekzistojnë edhe kompetenca të gjykatave kushtetuese që objektivisht shërbejnë si terren i pëlleshëm për aktivizmin gjyqësor. Pa pretenduar se fjala është për

---

109 Cf. *Rasti KO 43/19. Aktgjykim. Parashtrues:. Albulena Haxhiu, Driton Selmanaj dhe tridhjetë deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. o6/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 27 qershor 2019. Nr. ref.: 1387/19.

110 Cf. seksioni 16.11 i kapitullit të gjashtëmbëdhjetë.

një listë shteruese, në fund të këtij seksioni japim edhe këto kompetenca që zakonisht shërbejnë si terren për **aktivizëm gjyqësor** të gjykatave kushtetuese. Disa nga fushat që shërbejnë si terren potencial për aktivizëm gjyqësor, janë si vijon:

- frenimi i tendencave despotike dhe autoritare të organeve të caktuara të pushtetit (në nivel qendror/horizontal dhe në nivel lokal/vertikal);
- veprimi me qëllim të shtendosjes së konfliktit shoqëror, duke i shtyrë kah rruga juridike të gjitha problemet që rrezikojnë prishjen e rendit kushtetues;
- veprimi me qëllim të harmonizimit të vlerave, parimeve dhe normave kushtetuese me vlerat, parimet dhe normat juridike të nivelit mbinacional;
- veprimi i gjykatës si një dhomë e dytë e parlamentit në rastet e **impechement**-it, kur një gjë e tillë në kushtetutë nuk është e qartë e përcaktuar si duhet;
- veprimi në sferën e kontrollit të zgjedhjeve dhe aktivitetit kushtetues të partive politike; dhe
- ushtrimi i funksionit kriminal (penal) për rastet e gjykimeve të zyrtarëve të lartë shtetëror.

14.3. Aktivizmi në sferën e kompetencës procedurale

Që në fillim duhet thënë se, në parim, **aktivizmi gjyqësor** në sferën procedurale është i paktë dhe mjaft periferik. Kjo për shkak se normat procedurale kanë të bëjnë me menaxhimin e rastit kushtetues deri në vendosjen e tij përfundimtare (qoftë ajo vendosje meritore ose jo). E, megjithatë, **aktivizmi gjyqësor** ekziston edhe në këtë sferë të jetës dhe punës së gjyqtarëve kushtetues. Pikërisht për këtë, diskutimi në këtë seksion nis me ato pak raste që mund të cilësohen si periferike, jo pse ato nuk kanë rëndësi dhe peshë në gjyqësinë kushtetuese, por sepse të tilla janë krahasuar me vendimmarrjen që ka të bëjë me meritat e një kërkese kushtetuese. E kemi fjalën këtu për afatin brenda të cilit, sipas kushtetutës dhe ligjit vendor që normon vendimmarrjen kushtetuese, duhet të merret vendimi nga ana e një gjykate kushtetuese.

Afatet për vendimmarrjen në gjyqësinë kushtetuese janë pjesë e procedurës. Mosmarrja e vendimit në kohën e përcaktuar me kushtetutë (dhe ligjin nacional që normon organizimin dhe funksionimin e një gjykate kushtetuese), apo mosvendosja në një kohë të arsyeshme (në rastet kur nuk ekziston një afat kushtetues dhe ligjor për vendimmarrje, siç është rasti me kërkesat sipas ankesës kushtetuese), në shikim të parë mund të duket si një instrument i **vetëpërmbajtjes gjyqësore**. Kjo, megjithatë, nuk është kështu: vonesat antikushtetuese dhe antiligjore, si dhe vonesat e paarsyeshme për të vendosur lidhur me kërkesën e palës në një procedurë kushtetuese **paraqet aktivizëm të hapur gjyqësor** sepse cenon liritë dhe të drejtat njerëzore, duke mundësuar krijimin e rrethanave dhe zhvillimin e proceseve shoqërorë të një natyre dhe drejtimi tjetër nga ai që do të kishte qenë sikur gjykata të kishte vendosur lidhur me kërkesën kushtetuese në kohë. Kjo shpjegon se përse në disa vende në **Ballkan** ekzistojnë mjete të veçanta juridike kundër vonesës së vendimmarrjes, si një bazë e veçantë për cenimin e lirive dhe të drejtave kushtetuese.

Të lidhura ngushtë me afatet dhe respektimin e tyre si një **loci i aktivizmit gjyqësor** janë edhe dy situata të tjera, që kanë natyrë procedurale dhe në të cilat potencialisht ankorohet aktivizmi i gjyqtarëve kushtetues. Situata e parë ka të bëjë me shpalljen si të palejueshme për gjykim dhe vendosje meritore të rasteve të paraqitura në gjykatë. Ngushtësisht e lidhur me këtë është situata e dytë, e cila shfaqet atëherë kur gjykata kushtetuese me vendim jomeritor, që në Kosovë quhet **aktvendim**, vendos për ndryshimin e precedentit të krijuar me vendim meritor, i cili në **Kosovë** dhe në një pjesë të madhe të vendeve që kanë gjyqësi kushtetuese quhet **aktgjykim**.

Shpallja e rasteve si të **palejueshme për shqyrtim dhe vendosje meritore**, duke refuzuar kërkesën si **qartazi të pabazuar** apo për shkaqe të tjera që lidhen me arsye që mund të sanohen në një fazë të mëvonshme të procedurës gjyqësore, nuk paraqet asgjë tjetër pos një aktivizëm gjyqësor i veshur me petkun e lirisë së vendosjes së gjyqtarit kushtetues. Kjo është kështu në veçanti në rastet kur bëhet fjalë për ankesat individuale: shpallja e një rasti si **qartazi të pabazuar** në një fazë të mëvonshme mund ta sjellë gjykatën kushtetuese respektive në një situatë të palakmueshme sepse gjendja faktike kushtetuese mund t'i jep të drejtë palës së refuzuar për shkak se nuk ka arritur të argumentoj themelet e kërkesës së

vet. Kjo situatë mund të lindë edhe në rastet kur kërkesa shpallet si e palejueshme për shkak të vlerësimit që gjykata respektive e bën lidhur me natyrën juridike dhe efektivitetin e mjeteve juridike që pala i ka në dispozicion brenda sistemit juridik nacional. Në një rast të tillë, **gjykata gabimisht mund të vlerësoj se një mjet nuk është shterur, në ndërkohë që shterja e tij mund të mos sjellë asnjë dobi për palën për shkak se nuk paraqet një efektiv juridik**. Po ashtu, mund të ndodhë që shterja e mjetit juridik dhe mbyllja e tërësishme e procedurave pranë gjyqësorit të rregullt prodhon një situatë paradoksale që viktimizon edhe më shumë palën që ka ushtruar ankesën kushtetuese. Në Kosovë, i tillë ka qenë, ta zëmë, rasti **Emrush Kastrati**. Ky rast ka pasur të bëj më një gjyqtar të **Gjykatës Komunale** në **Malishevë**, i cili akuzohej për korrupsion. Lënda kishte kaluar në **Deçan** për shkak të konfliktit të përgjithshëm të interesit në **Gjykatën e Malishevës**, ku **Emrush Kastrati** kishte shërbyer si gjyqtar dhe ku ishte dyshuar për mitmarrje. Në atë kohë ka ekzistuar instituti i a.q. konfirmimi i aktakuzës. Dy gjykatat e shkallës së ulët, shkalla e parë dhe shkalla e dytë, kishin vendosur në favor të të akuzuarit, ish-gjyqtarit **Emrush Kastrati**. Kur lënda kishte shkuar në **Gjykatën Supreme**, sipas **Kërkesës për Mbrojtjen e Ligjshmërisë**, dy vendimet e shkallëve të ulëta ishin prishur me konstatimin se kishte pasur shkelje ligji në favor të të pandehurit. Me këtë rasti konsiderohej i mbyllur pranë gjyqësorit të rregullt, gjë që nënkuptonte se pala e dëmtuar me korrupsion mund të kërkonte vetëm kompensim të dëmit civil. E thënë me fjalë të tjera, pala që ka pësuar dëm nga ish-gjyqtari Emrush Kastrati në favor të të cilit është shkelur ligji, nuk ka në duar asnjë mjet efektiv për të sfiduar vendimet e padrejta të gjyqësorit kosovar, pos zhdëmtimit civil eventual. Kjo është kështu për shkak se, në Kosovë, sipas legjislacionit pozitiv penal, kur **Gjykata Supreme** konstaton se ka pasur shkelje të ligjit penal në favor të të pandehurit, vendimi nuk prishet. Kjo do të thotë se ky konstatim i **Gjykatës Supreme** ka vetëm efekt deklarativ dhe me kaq mbaron puna.

Në **Gjykatën Kushtetuese**, vendimi kishte qenë i papranueshëm për shkak se si palë ankuese ishte paraqitur ish-gjyqtari **Emrush Kastrati**, njëherë me kërkesë për vënien e masës së përkohshme[111] e herën tjetër me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij për shkak të **imunitetit funksional të gjyqtarëve e prokurorëve,**[112] i cili imunitet, sipas tij, duhej ta mbronte nga ndjekja për vendimmarrje si gjyqtar në **Gjykatën Komunale** në **Malishevë**. Arsyeja për papranueshmëri kishte qenë **mosshterja e mjeteve juridike**, përkatësisht **Gjykata Kushtetuese** kishte thënë se pala ankuese, ish-gjyqtari **Emrush Kastrati**, nuk kishte shterur të gjitha mjetet juridike brenda sistemit të gjyqësorit të rregullt, para se të vinte në **Gjykatën Kushtetuese**. Këtu, në fakt, nuk kishte çfarë të shteret më: kur Gjykata Supreme konstaton në procedurën sipas **KML** se është shkelur ligji në favor të të akuzuarit, atëherë kjo çështje mbyllet me kaq dhe palës së dëmtuar i ngelet vetëm që të ndjekë procedurat civile për kompensim të dëmit eventual ose të ndjekë procedurat si **paditës subsidiar penal** (me legjislacionin e ri penal më nuk ekziston procedura e paditësit subsidiar penal).

Pala e dëmtuar, e cila e kishte denoncuar rastin për mitmarrje të ish-gjyqtarit **Emrush Kastrati**, kishte marrë këtë vendim të **Gjykatës Kushtetuese** dhe me ngulm kishte kërkuar që **Gjykata Themelore në Deçan** të niste procedurën kundër ish-gjyqtarit **Emrush Kastrati** sepse i njëjti nuk kishte shterur të gjitha mjetet juridike, siç kishte deklaruar me aktvendim Gjykata Kushtetuese.[113]

Kjo situatë, në vetvete përbënte një paradoks të madh: në vend se Gjykata Kushtetuese të vendoste rreth kërkesës kryesore të ish-gjyqtarit **Emrush Kastrati**, i cili pohonte se kishte vepruar nën imunitetin funksional, ajo e shpalli rastin si të palejueshëm për shkak të mosshterjes së mjeteve

---

111 *Rasti KI 68/09. Vendim lidhur me Kërkesën për Masë të Përkohshme. Parashtrues: Emrush Kastrati kundër Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. Nr. 120/08, të datës 1 shtator 2009*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, 19 shkurt 2010 Nr. ref.: RMP *16/10.*

112 *Rasti KI 68/09. Vendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Emrush Kastrati kundër Vendimit te Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. Nr. 120/08, të datës 1 shtator 2009*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtinë, 21 qershor 2010 Nr. ref.: RK *16/10.*

113 **Rasti KI 68/09:** paragrafët 13-15 & 17.

juridike. Ish-gjyqtari **Emrush Kastrati**, këtë kërkesë për konstatim të imunitetit e kishte paraqitur për shkak se, pas vendimit të **Gjykatës Supreme,** që konstatonte shkeljen e ligjit penal në favor të tij, sërish kishte aplikuar për gjyqtar dhe ishte refuzuar meqë komisioni për përzgjedhje kishte konstatuar, me plot të drejtë, se në rastin e konfirmimit të aktakuzës kishte ndodhur shkelja e ligjit në favor të ish-gjyqtarit **Emrush Kastrati**. Kjo shkelje e ligjit e mbyllte çështjen, pa e ditur (konstatuar) fare fajësinë e këtij gjyqtari në rastin konkret të korrupsionit.

Në këtë rast, **Gjykata Kushtetuese** është dashur të tregojë se kush është organi kompetent sipas standardeve kushtetuese komparative që vendos për imunitet, në mënyrë që çështja kushtetuese e imunitetit të adresohet nga ai organ. Vetë petitumi i kërkesës së ish-gjyqtarit **Emrush Kastrati** ka qenë sqarimi nëse ai kishte pasur **imunitet funksional** në rastin e akuzave për korrupsion të ngritura kundër tij.[114] Kjo përgjigje rreth imunitetit i duhej ish-gjyqtarit në fjalë për t'u rizgjedhur sërish, pas kalimit të procesit të **vetingut** që po zhvillohej atëbotë në Kosovë. Këtë vendim **Gjykata Kushtetuese** nuk e mori, duke konstatuar në mënyrë të gabuar se organi kompetent për këtë ishte gjykata penale:[115] as gjykata penale e as **Gjykata Kushtetuese** nuk janë kompetente për një gjë të tillë, por organi që e ka veshur me imunitet funksional personin përkatës, funksionarin ose bartësin tjetër të pushtetit publik. Ky sqarim për imunitet çdoherë bëhet sipas kërkesës së organit të akuzës, i cili ka interes juridik për të ditur caqet llojin e imunitetit. Sikur Gjykata Kushtetuese t'i kishte dhënë përgjigje kërkesës kryesore të ish-gjyqtarit **Emrush Kastrati**, një vendim i tillë do të kishte lehtësuar dukshëm vendimin e mëvonshëm për imunitetin e deputetëve dhe funksionarëve të lartë shtetëror të Kosovës, nisur nga fakti se ky vendim do të kishte qenë i bazuar në një rrethanë jetësore konkrete, jo në ngjarje e situata hipotetike, siç ka qenë rasti me imunitetet e deputetëve dhe ish funksionarëve të larët shtetëror. Këtë çështje tanimë e kemi sqaruar disa herë dhe më shumë se kaq nuk do të vazhdojmë diskutimin tonë.[116]

Rasti **Emrush Kastrati** duhet të shërbej si vërejtje për të gjithë se **mosshterja e mjeteve juridike** duhet të vlerësohet me shumë kujdes sepse mund të krijoj situata paradoksale që mund ta sjellin Gjykatën Kushtetuese në pozitën e viktimizuesit të palëve në procedurë. Kjo gjendje, me pastaj, kur një ditë të arrij në **Gjykatën e Strasburgut,** mund ta fus në telashe gjyqësinë kushtetuese kosovare, e cila mund të shihet si vitimizuese dhe cenuese e të lirive dhe drejtave të qytetarëve të vet, jo gjyqësori vendor ose organet tjera.

Sa i përket shpalljes së papranueshme të një kërkese, për çfarëdo arsye tjetër, por që mëton të ndryshojë një precedent të krijuar me **vendim meritor**, gjendja paraqitet më ndryshe dhe më dramatike. Në një rast të tillë, Gjykata Kushtetuese e shpallë si palë ligjërisht të paautorizuar atë palë që deri dje ka qenë e tillë, pa i shqyrtuar fare meritat e rastit. Një gjë e tillë bëhet edhe më e dukshme kur gjykata e shpallë si të papranueshëm rastin për shkak të mungesës së **legjitimimit aktiv**, mirëpo në të njëjtën kohë lëshohet edhe në substancën e kërkesës duke e gjetur të njëjtën kërkesë pa merita (pa substancë), duke e shpallur kërkesën në fjalë si **qartazi të pabazuar**. Këtu kemi parasysh jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese viteve të fundit, e cila ka shpërfytyruar standardet e vëna kaherë për lejushmërinë e rasteve kur si palë paraqitet subjekti i privilegjuar kushtetues. Të shohim tani dy bazat e shpalljes së papranueshme të kërkesave që mbështeten në arsyet e mosargumentimit të duhur të themeltësisë së bazave të kërkesës (**petituimit**).

Shpallja e një kërkese si qartazi të pabazuar definohet me rregulloren 39.2 ["Kriteret e pranueshmërisë"] të **RP**, ku thuhet si vijon:

"[...] (2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

---

[114] **Rasti KI 68/09**: paragrafi 4.

[115] **Rasti KI 68/09:** paragrafi 16.

[116] Cf. seksioni 11.1 i kapitullit të njëmbëdhjetë të këtij libri, fusnota nr. 47, si dhe komentet tona aty; seksioni 12.3.3 të kapitullit të dymbëdhjetë, ku shtjellohet gjerësisht imuniteti i gjyqtarëve dhe funksionarëve të lartë shtetëror.

Në këto raste, shihet qartë se Gjykata vlerëson, sipas gjykimit të saj të supozuar profesional, vetëm nëse kërkesa e parashtruar përmban merita (substancë) për vendosje. Në ndërkohë që në rastet që kanë të bëjnë me kërkesat individuale, një gjende e tillë mund të tolerohet sepse rasti mund të rikthehet për gjykim dhe vendosje dhe mund të sanohet gabimi fillestar, kjo ngaqë vendimet në rastet e kërkesave individuale kanë efekt **inter partes**, në rastet e kërkesave të parashtruara nga palët që kanë status të privilegjuar (shefi i shtetit, organi ligjvënës, deputetët në një numër të caktuar, ekzekutivi nacional, avokati i popullit etj) gjendja paraqitet më ndryshe dhe më serioze. Kjo nga shkaku se në procedurat që kanë palë nisëse subjektet e privilegjuara si më sipër bëhet fjalë për aktivizëm që prek interesin e përgjithshëm të publikut. Në këto procedura, sikundër dihet, vendimet kanë efekt të përgjithshëm (**erga omnes**), që definohet si detyrim sistemik për të gjithë subjektet e së drejtës për t'i përshtatur sjelljet e tyre me verdiktin e Gjykatës.

Raste të tilla janë të shumta, mirëpo ne në vijim marrim vetëm disa që janë vendosur së fundi dhe që reflektojnë në mënyrë emblematike situatën që diskutojmë. E kemi fjalën për rastin lidhur me zgjedhjen e **Presidentit të Republikës** dhe rastin e kërkesës kushtetuese të **Presidentit të Republikës** për interpretim të dispozitave të nenit 18.2 të Kushtetutës lidhur me statusin kushtetues të marrëveshjeve të nënshkruara nga Presidenti i Republikës.[117] I pari njihet si rasti i zgjedhjes së **Presidentit Thaçi,**[118] kurse i dyti si rasti i **Gjykatës Speciale.**[119]

Në rastin **Presidenti Thaçi**, fjala ka qenë për një **aktvendim për papranueshmëri**, me të cilin u shpall si qartazi e pabazuar kërkesa e parashtruesve, e cila ka pasur të bëj me vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të Kuvendit të Kosovës për zgjedhjen e zt. Hashim Thaçi për President të Kosovës.[120] Objekt i kontrollit kushtetues, pra, ka qenë një vendim i **Kuvendit të Kosovës**, krejtësisht i njëjtë për nga natyra me vendimin për **rastin Pacolli**. Pas shqyrtimit nga Gjykata, kërkesa u shpall si e pa substancë për vendosje meritore. Kjo do të thotë që Gjykata arriti në përfundimin se nuk duhej lejuar që kërkesa të shqyrtohej në meritat e saj për shkak se parashtruesit nuk kishin arritur të argumentonin mjaftueshëm se bëhej fjalë për çështje kushtetuese. Përkundër këtij qëndrimi, Gjykata vendosi në një mënyrë krejtësisht arbitrare që të futej në meritat e rastit duke "ndryshuar" precedentin e vet në **rastin Pacolli,**[121] rast që, sikundër dihet, u ndërtua me një aktgjykim, i cili, me argumentim me bazë nga e drejta kushtetuese komparative, pat anuluar vendimin e **Kuvendit të Kosovës** për zgjedhjen e **Behxhet Pacollit** për president të Kosovës.[122]

---

117 Neni 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] i Kushtetutës:
"1. Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e dy të tretave (2/3) e të gjithë deputetëve ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare për këto çështje: (1) territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake; (2) të drejtat dhe liritë themelore; (3) anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare; (4) marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës.
2. Marrëveshjet ndërkombëtare me përjashtim të atyre në pikën 1, ratifikohen pas nënshkrimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës."

118 *Rasti KO 47/16. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Aida Derguti, Bali Muharremaj, Enver Hoti dhe 25 deputete te tjerë të Kuvendit te Republikës se Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 05-V-233, të 26 shkurtit 2016, për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtine, me 4 prill 2016 Nr. ref.: RK 911/ 16.

119 *Rasti KO 131/18. Aktvendim për Papranueshmëri . Parashtrues: Presidenti i Republikës së Kosovës . Kërkesë për vlerësim të konfliktit në mes të kompetencave kushtetuese të Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës, sic është përcaktuar me nenin 113.3 (1) të Kushtetutës*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, 25 mars 2019 . Nr. ref.: RK 1339/19.

120 *Rasti K0 47/16. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Aida Dërguti, Bali Muharremaj, Enver Hoti dhe 25 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr, 05-V-233, të 26 shkurtit 2016, për zgjedhjen e Presidentit të Republikes*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 4 prill 2016 . Nr. ref.:RK911/ 16.

121 *Rasti KO 29/11. Aktgjykim. Parashtruesit: Sabri Hamiti dhe deputetë të tjerë. Vlerësimi i kushtetutshmërisë të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, i datës 22 shkurt 2011.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtine, me 30 mars 2011 Nr. ref.: AGJ 107/11.

122 "[…] GJYKATA, në seancën e mbajtur më 28 mars 2011, I. SHPALL, njëzëri, se Kërkesa është e PRANUESHME; II. SHPALL, me shtatë vota për dhe dy kundër, se Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, më 22 shkurt 2011, është jo-kushtetues - dhe nuk do të jetë në fuqi nga data e publikimit të tij në përputhshmëri me nenin 116.3 të Kushtetutës - meqenëse është në kundërshtim me kërkesat e nenit 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe parimet demokratike të mishëruara aty". **Rasti KO 29/11.**

Esenca e **aktivizmit gjyqësor** në këtë rast ka konsistuar në ndryshimin e një precedenti të vlefshëm, që ishte krijuar duke u bazuar në shtjellimin komparativ të një çështjeje kushtetuese, përkatësisht duke u bazuar në vlerësimin meritor të kushtetutshmërisë së procedurës dhe të kushteve thelbësore që duhen plotësuar për zgjedhjen e **Presidentit të Kosovës**. Përveç kësaj, **aktivizmi gjyqësor** në këtë rast ka përfshirë edhe vendosjen hipotetike të Gjykatës duke vlerësuar në mënyrë imagjinare një rast real, rastin e zgjedhjes në mënyrë kundërkushtetuese të **Behxhet Pacollit** për president të **Kosovës** (sic!). Në fakt, në rastin e aktvendimit për papranueshmëri të **Presidentit Thaçi**, Gjykata nuk ka bërë asgjë pos ka ri-interpretuar aktgjykimin e vet nga **rasti Pacolli** në një mënyrë hipotetike, pra jo dispozitat kushtetuese që kanë qenë relevante për vendosjen e rastit që ka qenë para saj, rastit të **Presidentit Thaçi**.[123] Ky aktivizëm i kornizuar në terma arbitrar, duke vlerësuar në mënyrë imagjinare një rast real që tanimë ishte vlerësuar meritorisht nga Gjykata në **rastin Pacolli**, ka për pasojë reale prishjen e **sigurisë juridike** në **Kosovë** sepse përmes **vendimeve jomeritore** është hapur dera për ndërtim dhe krijim të precedentëve gjyqësor. Kjo mënyrë krijimi e precedentit është e pashembullt në praktikën kushtetuese të vendeve të tjera: vetëm analiza dhe vendosja mbi meritat e rastit dhe mosmarrëveshjes konkrete përbën precedent, asnjëherë **analiza dhe vendosja jomeritore** mbi të njëjtat.

Se ky **aktivizëm gjyqësor** ka rezultuar në prishjen e **sigurisë juridike**, qartë u pa pak vite më vonë, kur edhe vetë **Gjykata Kushtetuese** u fut në huti lidhur me meritat e një kërkese të parashtruar nga Presidenti i Republikës, **Hashim Thaçi**, me të cilën synohej bllokimi i punës së **Gjykatës Speciale**, çështje së cilës i kthehemi në rreshtat vijues.

Pasi kishte nënshkruar një marrëveshje ndërkombëtare në pajtim me nenin 18.2 të Kushtetutës, Presidenti i Republikës, **Hashim Thaci**, kishte vendosur që të dërgoj në Gjykatë për interpretim nenin 18.2 të Kushtetutës, konform autorizimeve të zgjeruara kushtetuese të cilat u krijuan me aktivizëm gjyqësor dhe që i njihnin shefit të shtetit dhe ekzekutivit kosovar të drejtën që çdoherë të ngrisnin pranë saj çështje kushtetuese jashtë kompetencave të parapara me nenin 113. paragrafët 2 & 3 të Kushtetutës. Në ndërkohë, Gjykata, e mësuar me ndryshimin arbitrar të precedentit të vet me një vendim **jomeritor** apo **aktvendim,** shpalli si të papranueshëm një kërkesë tjetër të Presidentit të Republikës, në një rast që kishte të bënte me **Komisionin Qendror të Zgjedhjeve** (KQZ),[124] duke theksuar se rasti dilte jashtë kompetencave nga neni 113, paragrafët 2 & 3 të Kushtetutës, ashtu që tani e tutje shefi i shtetit dhe ekzekutivi nuk mund të gëzonin të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës për marrjen e mendimeve, efektivisht të natyrës këshillëdhënëse, në vijim të ushtrimit të funksioneve të tyre kushtetuese.[125]Arsyeja për këtë ishte, sipas Gjykatës, se tani ky institucion kishte ndërtuar një siguri në vetvete dhe nuk kishte nevojë për aktivizëm gjyqësor si përbërja e parë e saj në vitet e para formative (sic!).[126] Si argument kryesor i Gjykatës, pra,

---

123 Cf. **Rasti KO 131/18:** paragrafët 67-76.

124 *Rasti K0 79/18. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Presidenti i Republikës së Kosovës. Kërkesë për interpretim të nenin 139. paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtinë, 3 dhjetor 2018 Nr. ref.: RK 1294/ 18.

125 "[..] **67.** Në këtë kuptim, Gjykata është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës, sipas nenit 112, paragrafit 1 të Kushtetutës, në lidhje me rastet e ngritura para saj sikurse përcaktohet me nenin 113. Gjykata nuk merret me interpretime për çështje që lidhen me veprime ose mosveprime juridike të institucioneve kushtetuese për të cilat nuk është e autorizuar sipas nenit 113 të Kushtetutës. Prandaj, neni 112, paragrafi 1, i Kushtetutës nuk mund të interpretohet jashtë kontekstit të nenit 113 të Kushtetutës.

68. Në lidhje me kuptimin dhe me kufijtë e nenit 84 (9) të Kushtetutës, Gjykata thekson se kërkesat e parashtruara mbi këtë bazë mund të jenë të pranueshme vetëm brenda juridiksionit të rregullt të Gjykatës, të përcaktuar shprehimisht dhe qartë në nenin 113, paragrafët 2 dhe 3 të Kushtetutës". **Rasti KO 79/18.**

126 "[…] **71**. Praktika e mëhershme e Gjykatës në lidhje me trajtimin e kërkesave të parashtruara në kuptimin e gjerë të nocionit "çështje kushtetuese", duhet kuptuar në frymën e procesit të vendosjes së themeleve të gjyqësisë kushtetuese, si dhe të nevojës shoqërore që Gjykata në fillesat e saj të përfshihet në interpretime të neneve specifike të Kushtetutës, sidomos kur çështjet e parashtruara janë ndërlidhur me ushtrimin e kompetencave të Presidentit të përcaktuara me Kushtetutë; kur çështjet e ngritura kanë ndikuar në ndarjen e pushteteve; në ruajtjen e rendit kushtetues; si dhe kur çështjet e ngritura kishin implikime thelbësore në funksionimin e sistemit kushtetues të vendit (Shih Aktgjykimin në rastin KO 130/15, *Presidentja e Republikës* së *Kosovës,* të cekur më lart, paragrafët 104, 107 dhe 109. Shih, po ashtu, rastin nr. K0 103/ 14, *Presidentja* e *Republikës* se *Kosovës,* të cekur me lart, Aktgjykim i 1 korrikut 2014, paragrafët 27, 57 dhe 61).

72. Megjithatë, Gjykata në përbërjen e saj aktuale, vlerëson se në përputhje të plote me gjuhën e qartë, shteruese dhe kufizuese të

ka shërbyer bindja me hamendje, krejtësisht **ekstra-juridike**, **ekstra-kushtetuese**, **metafizike dhe e pabazuar**, sipas të cilit përbërja e Gjykatës në vitet e para formative paska pas pasur nevojë për aktivizëm gjyqësor, rrethana këto që sot paskan pushuar së ekzistuari (sic!). Më vonë, në një paragraf tjetër, Gjykata ka provuar të mbështetet në një praktikë gjermane, por tërësisht në mënyrë të pavend: përvoja gjermane me dhënien e mendimeve këshillëdhënëse, nuk është ndërtuar si në Kosovë përmes një vendimi meritor (aktgjykimi), por përmes një ligji organik që normon organizimin dhe funksionimin e **Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë (GJKGje)**, ashtu që me ndryshimin e këtij ligji ka pasuar edhe braktisja e praktikës gjyqësore e dhënies së vendimeve këshillëdhënëse.[127]

Shënojmë se, jashtë çdo dyshimi, ka qenë gabim nga fillimi aktivizmi gjyqësor i Gjykatës me të cilin u pat krijuar precedenti që shefit të shtetit dhe ekzekutivit kosovar ua njihte të drejtën për të adresuar pyetje dhe për të ngritur çështje kushtetuese jashtë juridiksionit nga neni 113, paragrafët 2 & 3 të Kushtetutës. Këtë e kemi konstatuar në komentarin e Kushtetutës së Kosovës që në vitin 2013.[128] Ajo që vërtetë ngelet gjë e shëmtuar dhe e keqe në praktikën e gjyqësisë kushtetuese kosovare dhe që prish sigurinë juridike në vend ka të bëjë me instalimin e një **aktivizmi gjyqësor** të ri të Gjykatës, i cili rezulton në ndryshimin e precedentit të ndërtuar me vendim meritor apo aktgjykim**. Kjo është keq dhe e shëmtuar sepse, sikundër dihet, vendimi meritor apo aktgjykimi mund të ndryshohet vetëm më një vendim të natyrës së njëjtë e asnjëherë ndryshe, ose me amendament kushtetues, i cili ka fuqinë e normës kushtetuese**. Kur është ndërtuar, ky precedent ka qenë i krijuar me **vendim meritor** apo **aktgjykim** dhe kjo nuk ka paraqitur ndonjë rrezik sepse ka mund të ndryshohet më vështirësi, me amendament ose me vendim që ka fuqi të njëjtë juridike. Kjo qasje, me gjithë faktin që në përmbajtje ka qenë aktivizëm i gabuar, në thelb ka ofruar **siguri juridike** dhe **parashikueshmëri të normës** të ndërtuar me precedent gjyqësor .

Në rastin e **Gjykatës Speciale**, ky nuk ka qenë rasti, gjë që u pa nga vetë hutia e Gjykatës Kushtetuese, e cila ra viktimë e ndryshimit arbitrar të precedentëve të vendosur me vendim meritor (aktgjykim): pasi e kishte shpallur të palejueshëm rastin e **KQZ** (rasti **KO 79/18**) për mungesë legjitimiteti aktiv të shefit të shtetit në kërkesat që referohen sipas nenit 84.9 të Kushtetutës, vetë Gjykata i dërgoj një letër **Presidentit të Republikës**, duke i kërkuar që të jepte përgjigje, në fakt duke e udhëzuar se si mund ta ndryshonte kërkesën e vetë origjinale dhe ta riformulonte ashtu që ajo të dukej si një kërkesë e **konfliktit për kompetencë**, që bie në kuadër të dispozitave të nenit 113 paragrafi 3 të Kushtetutës. Në kërkesën origjinale, Presidenti kishte kërkuar interpretim nga **Gjykata Kushtetuese** të nenit 18 ["Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare"] të Kushtetutës, përkatësisht kishte kërkuar që Gjykata të tregojë nëse marrëveshjet e nënshkruara nga Presidenti sipas nenit 18.2 duhet të ratifikohen në Kuvend. Me këtë kërkesë, në mënyrë specifike, Presidenti ka dashur të merr bekimin nga Gjykata për të dërguar për ratifikim në Kuvend marrëveshjen e qershorit 2018, të cilën e kishte nënshkruar dhe e cila kishte hyrë në

---

nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të gjitha referencat tjera në Kushtetutë që ndërlidhen me ngritjen e çështjeve kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese, burojnë nga neni 113. "*Rasti KO 79/18. Aktvendim për Papranueshmëri*.

127 "[…]**76.** Duke u nisur nga fakti që Kushtetuta ka përcaktuar shprehimisht juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, përfshirë edhe palët e autorizuara për aktivizimin e juridiksionit të saj, Gjykatës i është kufizuar mundësia që të marrë rol konsultativ apo këshillëdhënës, ngase ky rol do të binte ndesh me rolin e saj themelor për vendosjen e rasteve të ngritura para saj. Praktika e vendeve të tjera njeh raste kur gjykatat kushtetuese kanë ushtruar juridiksion këshillëdhënës, por me vonë një praktikë e tille e juridiksionit të natyrës konsultative është hequr për shkak të inkompatibilitetit të saj me natyrën vendimmarrëse të gjykatave kushtetuese. Konkretisht, në rastin e Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë, Ligji për Gjykatën Federale Kushtetuese, në fillet e ekzistimit të saj kishte paraparë mundësinë e dhënies së mendimeve këshillëdhënëse nga kjo gjykatë (Ligji për Gjykatën Federale Kushtetuese të Gjermanisë, *BVerfGG,* i 12 marsit 1951). Megjithatë, vetëm disa vite më vone, për shkak të natyrës detyruese të "mendimeve këshilluese", dispozita e ligjit të lartcekur, që lejonte një juridiksion të tillë, ishte shfuqizuar (me 21 korrik 1956)." **Rasti K0 79/18.**

128 Shih komentet tona për juridiksionin dhe palët e autorizuara që kanë të bëjnë me kompetencat e palëve të privilegjuara nga neni 113. 2 & 3 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] të Kushtetutës. Enver Hasani & Ivan Cukallovic, *Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Komentar* (GIZ: Prishtinë, 2013), fq. 573-585.

fuqi menjëherë në pajtim me nenin 18.2 të Kushtetutës, duke shërbyer kësisoj si bazë juridike për operimin e **Gjykatës Speciale** në territorin e Kosovës, përkatësisht për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara në vijim të ekzekutimit të urdhrave të kësaj Gjykate (që e ka selinë në Hagë).[129] Për Gjykatën Speciale gjerësisht kemi diskutuar më herët në këtë libër.[130] Kjo letër e Gjykatës, drejtuar **Presidentit të Kosovës**, me fjalë të tjera, kërkonte nga i njëjti që të sqarohej nëse dëshironte të ripërsëriste kërkesën e vet në Gjykatë, por tani duke u bazuar në konfliktin për kompetencë nga neni 113 paragrafi 3 të Kushtetutës. Krejt kjo u bë pas refuzimit të Gjykatës për të shpallur si të lejueshme kërkesën në rastin **KO 79/18** (rasti **KQZ**), për mungesë legjitimitetit aktiv në kërkesën e parashtruar sipas nenit 84.9 të Kushtetutës.

Kjo qasje aktiviste në fazën e tillë të zhvillimit të procedurës përbën një skandal të llojit të vet sepse Gjykata këtu paraqitet në rolin e avokati të Presidentit të Republikës. Në të njëjtën kohë, kjo përbën edhe shkelje të **normave etike** të profesionit të gjyqtarit kushtetues. Këtë rrethanë e ka evidentuar edhe një pjesës e **medies kosovare.**[131] Mbase **reagimi i medies** ka qenë shkaku kryesor pse në fund Gjykata edhe kërkesën e dytë e shpalli si të palejueshme, ani se vetë e kishte udhëzuar **Presidentin e Kosovës** që ta paraqesë kërkesën në Gjykatë.[132] Nuk ka asnjë dyshim se në rastin e dytë as që mund të bëhej fjalë për **konflikt për kompetencë** në mes të Presidentit dhe Kuvendit, nisur nga fakti se ky i fundit asnjëherë nuk e kishte kontestuar të drejtën e shefit të shtetit kosovar për të lidhur marrëveshje nga neni 18.2 i Kushtetutës. Ajo që është kontestuar dhe vazhdon të kontestohet në publik ka të bëj me marrëveshjet ndërkombëtare nga neni 18.1 i Kushtetutës, të cilat as Presidenti dhe askush tjetër pos Kuvendit **të Kosovës** nuk mund t'i negociojë dhe lidhë pa pëlqimin e përfaqësuesit të sovranit të Kosovës – vetë Kuvendit.

---

[129] " […] **Objekti i çështjes**
2. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësim të konflikt të kompetencës kushtetuese në mes të Presidentit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Presidenti) dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi).
3. Pretendimi për konflikt të kompetencës kushtetuese ndërlidhet me kompetencat kushtetuese të përcaktuara për Presidentin dhe Kuvendin në nenin 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës. Presidenti, si palë që ka ngritur pretendim për konflikt në mes Presidentit dhe Kuvendit pretendon paqartësi rreth kompetencës kushtetuese për ratifikimin e Shkëmbimit të Letrave në mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, si në vijim:
*"**1.** Letrat e shkëmbimit në mes të Presidentit të Republikës së Kosovës (04.06.2018) dhe Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë (08.06.2018) [Shkëmbimi i Katërt i Letrave]:*
***1.1.** a duhet të ratifikohen në cilësinë e Marrëveshjes Ndërkombëtare, nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve (në pajtim me Nenin 18.1. të Kushtetutës) apo*
***1.2.** a duhet të konsiderohen të ratifikuara pas nënshkrimit nga Presidenti (në pajtim me Nenin 18.2 të Kushtetutës), për shkak të ndërrimit te rolit dhe mandatit ekzekutiv të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, pasi që tani e tutje do të ketë rol kryesisht këshillëdhënës dhe monitorues."*
[…]
13. Më 3 dhjetor 2018, Gjykata publikoi Aktvendim për Papranueshmëri në rastin K0 79/18, ku parashtrues i kërkesës ishte Presidenti. Në atë rast, Presidenti, në bazë të paragrafit (9) të nenit 84 të Kushtetutës, kishte kërkuar nga Gjykata që të interpretojë paragrafin (4) të nenit 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve] të Kushtetutës. Gjykata e kishte shpallur kërkesën të papranueshme dhe kishte konstatuar se neni 84 (9) nuk është i pavarur prej nenit 113 të Kushtetutës dhe se parashtrimi i çështjeve kushtetuese në Gjykatë duhet të bëhet vetëm mbi bazën e nenit 113 të Kushtetutës.
14. Më 11 dhjetor 2018, Gjykata, duke pasur parasysh faktin që kërkesa K0 131/18 ishte dorëzuar në Gjykatë, para vendimmarrjes së saj në rastin K0 79/18, ku përcaktoi se kërkesat e Presidentit në Gjykatë nuk mund të bazohen vetëm në nenin 84 (9) të Kushtetutës, por janë të ndërlidhura me nenin 113 të saj, kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të sqarojë kërkesën e tij dorëzuar në Gjykatë, duke i dhënë kështu mundësinë që ta sqarojë dhe arsyetojë pranueshmërinë e kërkesës K0 131/18. Gjykata po ashtu e njoftoi parashtruesin e kërkesës lidhur me komentet e dorëzuara nga Misioni i EULEX-it si dhe i dërgoi një kopje të tyre. Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që sqarimet e tij lidhur me pranueshmërinë e kërkesës si dhe komentet e tij ndaj komenteve të EULEX-it, nëse ka, t›i dorëzojë në Gjykatë deri më 24 dhjetor 2018."
15. Më 24 dhjetor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi sqarimet e tij në Gjykatë, duke ngritur pretendime për konfliktit të kompetencës kushtetuese në mes të Presidentit dhe Kuvendit, bazuar në nën-paragrafin (1) të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës lidhur me kompetencat kushtetuese të përcaktuara në nenin 18 të Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës nuk dorëzoi ndonjë koment lidhur me komentet e EULEX-it."

[130] Cf. seksioni 10.3 i kapitullit dhjetë të këtij libri.

[131] Fitim Gashi, "Kushtetuesja ia bën 'avokatin' presidentit." **Koha Ditore** (e premte, 15 mars 2019) fq. 2-3.

[132] Fitim Gashi, "Kushtetuesja e rrëzon kërkesën e presidentit Thaçi". **Koha Ditore** (e martë, 26 mars 2019) fq. 2.

Sikur të ishte shpallur kërkesa e pranueshme, në rastin e parë ose në të dytin, atëherë marrëveshja e nënshkruar në verë të vitit 2018 për vazhdimin e punës së misionit **EULEX** në kapacitet dhe mandat tjetër, krejtësisht këshillues dhe joekzekutiv, do të duhej të dërgohej në Kuvend për ratifikim. Kjo, në mënyrë zinxhirore, do të kishte pasur për pasojë bllokimin e punës së **Gjykatës Speciale** në territorin e **Kosovës**, gjë që ka qenë qëllimi parësor i parashtruesit të kërkesës, **Presidentit të Kosovës.** Qëllim tjetër i kërkesës, po aq parësor, ka qenë që, nëse do të vendosej në favor të parashtruesit, të merrej drita e gjelbër për lidhjen e të gjitha llojeve të marrëveshjeje ndërkombëtare, përfshirë ato që ratifikohen nga Kuvendi nga neni 18.1 i Kushtetutës. Një gjë e tillë, për pasojë, do të ndryshonte natyrën e sistemit të qeverisjes në Kosovë, duke e shndërruar atë efektivisht në një **sistem gjysmë-presidencial**. Kjo, megjithatë, nuk ndodhi: kërkesa e dytë u shpall e papranueshme ashtu që puna e Gjykatës Speciale nuk u bllokua ngaqë nuk erdh deri te zgjerimi i kompetencave të **Presidentit të Republikës** në drejtim të shndërrimit të sistemit aktual qeverisës, sistemit të demokracisë kushtetuese parlamentare, në një **sistem semi-presidencial** apo diçka të ngjashme.

14.4. Teknikat e interpretimit që ndihmojnë aktivizmin gjyqësor

Për qëllimet e të kuptuarit të aktivizmit gjyqësor, dy teknika interpretimi ekzistojnë në përvojat e gjyqësisë kushtetuese evropiane dhe më gjerë. E para ndër to është e a.q. **teknika e përqafimit** (**deference**), e cila zbatohet gjatë testimit të kushtetutshmërisë së një akti juridik (të përgjithshëm apo individual) apo të një veprimi apo mosveprimi (**emetimi**) të autoriteteve shtetërore dhe autoriteteve të tjera publike, ku gjykatat ndërmarrin veprime dhe bëjnë përpjekje për shërimin e jokushtetutshmërisë së ndeshur të akteve dhe veprimeve apo mosveprimeve (emetimeve) kushtetuese. E dyta, ndërkaq, është e a.q. **teknika e interpretimit konform-kushtetutës** (**constitution-conform interpretation**).[133]

Secila nga këto teknika prodhon pasojat e caktuara që kanë të bëjnë me intensitetin dhe caqet e aktivizmit gjyqësor.

Teknika e parë e interpretimit në një gjykim kushtetues, **teknika e përqafimit**, vjen në shprehje si në marrëdhënien e gjykatave kushtetuese me ligjvënësin ashtu edhe në marrëdhëniet e këtyre dyjave me gjyqësorin e rregullt. Në rastin e parë ekzistojnë disa forma të manifestimit të respektit (përqafimit) të ligjvënësit dhe produktit të tij nga ana e gjykatës kushtetuese. Ato forma janë: **prezumimi i kushtetutshmërisë së ligjeve** dhe qasja ekskluzivisht si **ligjvënës negativ** e gjykatave kushtetuese me rastin e vlerësimit abstrakt të kushtetutshmërisë së normave. Sikundër dihet, dhe siç është vënë në dukje më herët në këtë seksion, forma e dytë konsiston në respektimin nga ana e gjykatave kushtetuese të diskrecionit të ligjvënësit, me përjashtim të rasteve kur bëhet fjalë për shkelje (cenime) serioze dhe të dukshme të kushtetutës. Në raste të tilla, **anulimi i produktit të ligjvënësit vjen në shprehje vetëm për aq sa është e nevojshme për të ndrequr (sanuar) shkeljen apo cenimin e kushtetutës**, përveç rasteve kur anulimi i pjesëve të produktit të ligjvënësit e bën të padobishëm dhe jofunksional produktin marrë si tërësi. Kjo është thelbi i **ligjvënies negative** ashtu siç ka qenë e skicuar prej **Hans Kelsen.**

Forma e **ligjvënies negative** paraqet një standard mjaft të përhapur në gjyqësinë kushtetuese evropiane dhe më gjerë. Ajo është shenjë dalluese klasike e kësaj gjyqësie krahasuar me format tjera të veprimtarive shtetërore. Në këtë formë veprimi, gjykatat kushtetuese kufizohen në rolin e tyre klasik të **ligjvënësit negativ**, duke mos ushtruar kontroll kushtetues më shumë se që është nevoja dhe, për pasojë, duke kufizuar caqet e anulimit të prodhimit të ligjvënësit vetëm për aq sa një gjë e tillë paraqitet si e domosdoshme. Me këtë koncept identifikohet vetë lindja e gjyqësisë kushtetuese në **Evropë**, që nga dita kur kjo shprehje u përdor nga arkitekti ideor i gjyqësisë kushtetuese evropiane, **Hans Kelsen**. Te kjo formë synohet të tregohet se, kur gjykatat anulojnë ligje, ato nuk bëjnë asgjë tjetër pos një veprim të ligjvënies specifike, e cila ka natyrë negative, në sensin që ligjvënësit i bëhet me dije dhe i vihet në dukje se si nuk duhet të veprojë në kundërshtim me parametrat dhe standardet e përcaktuara me kushtetutë.

[133] Maartje de Visser, *Constitutional Review in Europe: A Comparative Analysis*, fq. 281-309.

Para se të kalojmë të forma e dytë, **prezumimi i kushtetutshmërisë**, t'i shohim dy nga vendimet e rëndësishme të Gjykatës Kushtetuese që kanë trajtuar çështjet e **ligjvënies negative** ashtu siç u përshkrua më lartë. Njëri nga to është vendim meritor, aktgjykim, kurse tjetri vendim për masën e përkohshme. Në dyja rastet, sa për ilustrim të përzgjedhura, efekti ka qenë i njëjtë: anulimi efektiv i dispozitave specifike ligjore që nuk kanë qenë në pajtueshmëri me Kushtetutën. Vlen të theksohet se te ligjvënia negative vjen deri te anulimi i dispozitave relevante ligjore që janë gjetur si jo në pajtim me kushtetutën, në ndërkohë që pjesa tjetër e ligjit vazhdon jetën e vet, përveç nëse anulimi i dispozitave ligjore rezulton në bërjen e ligjit të pakuptimtë apo në tërësi të paaplikueshëm. Kjo qasje në ligjvënien negative, krejtësisht klasike, vetëm konfirmon respektimin e parimit të prezumimit të kushtetutshmërisë së ligjeve, si një parim më me prioritet se ligjvënia negative.

Në rastin e parë, i njohur si **rasti RTK** (Radio Televizioni i Kosovës), Gjykata ka shprehur pikëpamjen e vet si **ligjvënës negativ** me rastin e vënies së **masës së përkohshme** dhe me rastin e heqjen nga lista të rastit për shkak të ngeljes së procedurës gjyqësore pa objekt, që ndodhur si pasojë e veprimeve të vetë palës, përkatësisht **KEK** (**Korporata Energjike e Kosovës**), e cila ka refuzuar të inkasoj paratë e taksës në dobi të **RTK**-së. Në paragrafin 9 të vendimit për heqjen nga lista të rastit, Gjykata ka theksuar se, në përputhje me nenin 116 (2) të Kushtetutës, nenin 27 të Ligjit dhe nenin 52 në lidhje me nenin 59 të Rregullores së punës, ka nxjerrë një vendim, më 16 tetor 2009, me të cilin e ka vënë masë e përkohshme ndaj zbatimit të mëtejshëm të dispozitave të nenit 20.1 të **Ligjit për RTK**-në deri në vendosjen meritore të kërkesës. Në vendimin për vënien e masës së përkohshme, Gjykata i ka rekomanduar Kuvendit të Kosovës që ta rishikojë natyrën e nenit 20.1 të **Ligjit për RTK**-në dhe praktikat e bazuara në dispozitat e tij, të cilat praktika kanë pasur të bëjnë me inkasimin e taksës prej tre (3) eurove nga ana e **KEK** në dobi të **RTK.** Kjo do të thotë se Gjykata i ka **rekomanduar** Kuvendit që të rishikoj (lexo: ndryshoj) nenin kontestues të **Ligjit për RTK**-në, i cili kishte qenë shkaku i cenimit të të drejtave të parashtruesit të kërkesës për masë të përkohshme, zt. **Tomë Krasniqi**. Kjo konstatohet edhe në paragrafin 23, si dhe në vendimin origjinal për vënien e masës së përkohshme. Menjëherë pas kësaj, Kuvendi e ka informuar Gjykatën se kishte nisur iniciativa për ndryshimin e **Ligjit për RTK**-në. Kjo reflektohet në vendimin e Gjykatës për vazhdimin e masës së përkohshme, paragrafët 27-30, në ndërkohë që në paragrafin 31 të tij tregohet se janë hequr taksat në kurriz të qytetarëve nga Kuvendi dhe se ka nisur financimi i **RTK-**së nga buxheti i **Kosovës**. Kjo ishte në pajtim me paragrafin 29 të vendimit, në të cilin Gjykata theksonte se Kuvendi duhej të "[…] ta sajojë një skemë që është transparente, e drejtë, e qëndrueshme, që përmban mbrojtje efikase dhe përkatëse për lirimin e personave të varfër nga pagesa dhe që siguron synime të lavdërueshme për ofrimin e shërbimit të një transmetuesi publik të financuar në mënyrë adekuate.[134]

Një rast tjetër i rëndësishëm në vijim të praktikës gjyqësore me **ligjvënie negative** paraqet **rasti i Pensioneve të Deputetëve**.[135] Në këtë rast Gjykata në mënyrë shprehimore ka përqafuar qasjen e **ligjvënësit negativ** dhe e ka arsyetuar shumë mirë.[136] Në fakt, ky rast përbën të parin në praktikën e gjyqësisë

---

[134] *Rasti KI 11 /09. Vendim për Heqjen nga Lista të Kërkesës. Parashtrues: Tomë Krasniqi. Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 2.1 të Urdhëresës Administrative të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) Nr. 2003/12, dhe nenit 20.1 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës, Ligji Nr. 02/L-47*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtinë, 30 maj 2011. Nr. ref.: VHL 112/11.

[135] *Rasti KO 119/10. Aktgjykim. Parashtrues: Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë se nenit 14 paragrafit 1.6, nenit 22, nenit 24, nenit 25 dhe nenit 27 te Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, Nr. 03/L111, te 4 qershorit 2010*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtine, me 8 dhjetor 2011 Nr. ref.: AGJ 165/11. Paragrafët: 52, 54-55, 79-80, 82.

[136] Rastet tjera që kanë ndjekur këtë praktikë më pastaj janë, ta zëmë, rastet si vijon: *Rasti KO 131/12. Aktgjykim. Parashtrues: Dr. Shaip Muja dhe 11 deputet1 të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 18, 19,41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi, Nr. 04/L-125, të miratuar nga Kuvendi, më 13 dhjetor 2012*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 15 prill 2013. Nr. ref.: AGJ 404/13. Paragrafët: 127-175; *Rasti KO 142/16. Aktgjykim. Parashtrues: Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit . Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 10 dhe 40.1.5 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtinë, më 18 korrik 2017 . Nr. ref.:AGJ 1107/17. Paragrafët: 76, 90 & 103; & *Rasti KO 01/17. Aktgjykim. Parashtrues: Aida Dërguti dhe 23 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, 4 prill 2017. Nr. ref.: AGJ1053/17. Paragrafët: 75-76.

kushtetuese kosovare kur Gjykata me vendim meritor është prononcuar sipas standardit klasik të **ligjvënësit negativ**. Këtu, në fillim, ajo ka konstatuar **prezumimin e kushtetutshmërisë së ligjeve**, si një postulat i rëndësishëm i konstitucionalizmit modern. Pas kësaj, në rend të dytë, ka treguar se ia njeh **Kuvendit të Kosovës** të drejtën e ligjvënies, mirëpo në kuadër të kufijve dhe parametrave të përcaktuar me Kushtetutë. Ata kufij dhe parametra kushtetues nënkuptojnë ndjekjen e një qëllimi legjitim të përgjithshëm dhe duke respektuar parimin e proporcionalitetit në mes të qëllimit që synohet dhe lirive dhe të drejtave të individit dhe të subjekteve të tjerë të së drejtës. Me këtë Gjykata ka treguar shprehimisht se nuk përzihet në punët e Kuvendit, përveç rasteve kur Kuvendi me rastin e nxjerrjen së një ligji, si e drejtë e tij kushtetuese, nuk ka ndjekur qëllimin legjitim për nxjerrjen e tij sepse ka shkelur parimin kushtetues të proporcionalitetit në mes të qëllimeve legjitime që ndjek ligji dhe interesit të individit të garantuar me Kushtetutë. Në këto raste vjen deri të **rrëzimi i prezumimit të kushtetutshmërisë së ligjit**. Kjo qasje, megjithatë, në tërësi vërteton respektimin nga ana e Gjykatës të vullnetit të ligjvënësit, duke qëndruar në **kufijtë e ligjvënies së tij negative**, proklamuar nga **Hans Keslen**, gjithnjë me supozimin se Kuvendi respekton tri postulatet themelore të ligjvënies: e para, respektimi i Kushtetutës, germës dhe frymës së saj; e dyta, ligjvënia synon arritjen e një qëllimi legjitim publik; dhe, e treta, ai qëllim legjitim që ndiqet është proporcional me respektim të interesave individuale ngaqë merr parasysh liritë dhe të drejtat kushtetuese të individëve dhe subjekteve të tjerë të së drejtës.

Të vazhdojmë tani diskutimin e formës së dytë, atë të **prezumimit të kushtetutshmërisë së ligjeve,** si dhe rasteve kur respektimi i këtij parimi nuk çon në ligjvënie negative. Në thelb, **prezumimi i kushtetutshmërisë së ligjeve** që çon në anulim të dispozitave specifike të ligjit nuk është ndonjë respektim i këtij prezumimi dhe i vullnetit të përfaqësuesit të sovranit nacional - parlamentit. I tillë është vetëm atëherë kur prezumimi rezulton në **vetëpërmbajtje gjyqësore**, gjë që përbën praktikën më të shpeshtë të gjyqësisë kushtetuese. Këtë do ta cilësojmë si **prezumimi i kushtetutshmërisë së ligjeve** në kuptimin e ngushtë të fjalës, pra kur asnjë dispozitë e ligjit nuk anulohet dhe për këtë jepen arsye që lidhen me rolin dhe pozitën kushtetuese të organit të përfaqësuesit nacional - parlamentit.

Me qasjen e **prezumimit të kushtetutshmërisë së ligjeve**, gjykatat kushtetuese tregojnë se **ia lëshojnë rrugën ligjvënësit**, duke e konsideruar të njëjtin si më të përshtatshëm dhe më kompetent për të vlerësuar aspektet socio-politike, ekonomike, etike, psikologjike dhe aspektet e natyrës tjetër për normëvënie në fushat e caktuara të jetës, cilësi këto që nuk i kanë apo nuk i posedojnë gjykatat kushtetuese. Me rastin e zbatimit të kësaj forme, gjykatat kushtetuese zakonisht përdorin retorikën standarde duke thënë se nuk është punë e tyre për t'u **substituuar** (**zëvendësuar**) me ligjvënësin, i cili më së miri i din nevojat e shoqërisë për rregullim normativ të sferave të caktuara të jetës shoqërore dhe posedon legjitimitet demokratik për një gjë të tillë.

Te forma e **prezumimit të kushtetutshmërisë së ligjeve**, përqafimi apo respektimi gjatë kontrollit kushtetues të prodhimit të ligjvënësit shprehet dhe manifestohet te pjesa që ka të bëj me barrën e të provuarit dhe standardin e provës: pala e cila ka nisur në mënyrë të ligjshme procedurat e sfidimit të kushtetutshmërisë së një produkti të ligjvënësit duhet të ofroj prova bindëse dhe të thella për të dëshmuar jokushtetutshmërinë e produktit në fjalë. Kjo nënkupton se barra e provës bie në palën sfiduese, kurse vetë gjykatat kushtetuese nuk kanë mundësi që **sua sponte** të futen në meritat e rastit. Kjo nënkupton që **prezumimi i kushtetutshmërisë së ligjeve** shprehet në vendimmarrjet që për objekt vlerësimi kanë kërkesat e palës, përkatësisht rastet e kërkesave për vlerësim të kushtetutshmërisë së produktit të ligjvënësit kundrejt respektimit të përbërësve të **prezumimit të kushtetutshmërisë së ligjeve**. Ata përbërës kanë të bëjnë me respektimin e kushtetutës, ndjekjen e një qëllimi legjitim që përbën interes të përgjithshëm dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të individit dhe të subjekteve tjerë të së drejtës (proporcionaliteti) me rastin e ligjvënies. Këtu çdoherë bëhet fjalë për ligje që kanë hyrë në fuqi dhe ka nisur zbatimi i tyre. Ky fakt e dallon këtë parim nga **vetëpërmbajtja gjyqësore**, e cila mund të përdoret si në procedurat e **kontrollit preventiv** ashtu edhe në procedurat e **kontrollit represiv** të normës juridike. Kjo është arsyeja që vetëpërmbajtjen e kemi ndarë në seksion të veçantë për shkak se është më e gjerë si koncept dhe si praktikë pune në krahasim me parimin e **prezumimit të kushtetutshmërisë së ligjeve** dhe **parimin e proporcionalitetit.**

Në rastet kur pala nuk arrinë të dëshmojë se një ligj apo disa dispozita të tij nuk janë në pajtim me kushtetutën nacionale, atëherë **kërkesa refuzohet si qartazi e pabazuar** dhe, për pasojë, shpallet si e papranueshme për shqyrtim dhe vendosje meritore. Kjo nënkupton se këtu fiton konfirmim dhe qytetari të plotë, në një mënyrë triumfale, **parimi i prezumimit të kushtetutshmërisë së ligjit**, të atij ligji që ka qenë objekt i kontrollit kushtetues. Të shohim në vijim disa raste më të dalluara, të përzgjedhura me randomizim, në të cilat **GJKRKS** ka hedhur poshtë si qartazi të pabazuar kërkesën për vlerësim të kushtetutshmërisë së ligjeve, duke konfirmuar në këtë mënyrë prezumimin e kushtetutshmërisë së produktit të Kuvendit të Kosovës. E njëjta nuk mund të vlejë për produktin e Qeverisë, pra nuk mund të ketë prezumim të kushtetutshmërisë së veprimit ekzekutiv. Ai mund të prezumohet si i tillë vetëm pas një vendimi të gjykatës që konfirmon një gjë të tillë. E thënë me fjalë të tjera, në këto raste, **aktivizmi gjyqësor** duket të kërkohet në arsyetimin e vendimit të gjykatës kushtetuese sepse aty ankorohet kushtetutshmëria e produktit të ekzekutivit. Në fakt, këtu as që bëhet fjalë për prezumim të kushtetutshmërisë por për një vendim të gjykatave kushtetuese, me të cilin, në shenjë respekti, përligjësohet puna dhe produkti i ekzekutivit, duke e cilësuar atë si aktivitet normativ normal kushtetues. Kjo, në rastin e Kosovës, më së miri shihet te vendimi për **rastin e Rrogave**, ku Gjykata Kushtetuese ka konfirmuar në mënyrë shumë arbitrare kushtetutshmërinë e një vendimi individual të ekzekutivit kosovar mbi rritje e pagave pa pasur autorizim ligjor për një gjë të tillë. Në fakt, rritja e pagave ka ndodhur përkundër asaj që një hap i tillë nuk ka enë i autorizuar me ligjin për buxhetin të vitit respektiv.

Për të kuptuar si duhet këtë materie, në fillim diskutojmë praktikën e **GJKRKS** kur është **refuzuar kërkesa** për vlerësim të kushtetutshmërisë, për të kaluar pastaj në krahasimin e kësaj praktike me **rastin e Rrogave**. Këtë e bëjmë me qëllim që lexuesit t'i jepet mundësia për të gjykuar vetë mbi shkallën e aktivizmit të **Gjykatës Kushtetuese**. Shënojmë se këtu nuk bëhet fjalë për të gjitha rastet e deklarimit të papranueshëm të kërkesave si pasojë e mosplotësimit të prezumimeve procedurale, por vetëm për ato raste kur **kërkesa refuzohet si qartazi e pabazuar**. Të shohim si duket kjo.

Në **rastin e Investimeve Strategjike**, ku kërkesa u **refuzua ai qartazi i pabazuar**, Gjykata në paragrafët 70-76 i ka dhënë bazat për shpalljen e papranueshme të kërkesës. Në dy paragrafët e para, ajo ka vënë në spikamë qëllimet e nxjerrjes së Ligjit për Investime Strategjike në Kosovë duke treguar se ekzistojnë disa organe e institucione që janë në ngarkesë të zbatimit të tij. Kjo është bërë për të treguar se objektivi i ligjit është përmirësimi i zhvillimit ekonomik, punësimi dhe zbatimi i teknologjive të reja me qëllim të rritjes së aftësive konkurruese të Kosovës, si me qëllim të përmirësimit të mirëqenies së përgjithshme dhe kushteve të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës (paragrafi 72). Ky sqarim bëhej me qëllim për të dhënë një përgjigje në pretendimet e parashtresave që kishin thënë se ligji favorizonte vetëm komunitetin shqiptar, si komunitet shumicë në Kosovë. Për të rrëzuar këtë argument, Gjykata konstatoi se përfitimet e propozuara të ligjit nuk janë të kufizuara në një ose një tjetër komunitet, por janë me interes të përgjithshëm publik dhe synojnë mirëqenien e tërë shoqërisë (paragrafi 73). Krejt kjo u bë për t'u treguar parashtruesve që, sipas nenit 113.5 të Kushtetutës, është përgjegjësi e parashtruesve që të dëshmojnë pretendimet e tyre, përfshirë pretendimin se ligji i kontestuar është dashur të konsiderohej si ligj me interes vital brenda kuptimit të nenit 81.1 të Kushtetutës (**Shih, mutatis mutandis, rasti Nr. KO94/16, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, nr. 05/L-010, Aktvendim për papranueshmëri i 25 tetorit 2016, paragrafi 48**). Pas këtij konstatimi në paragrafin 74, Gjykata ka ardhur te përfundimi, në paragrafin 76, se kërkesa marrë si tërësi është qartazi e pabazuar. Në terma praktik, një gjë e tillë nënkupton se ligji ka legjitimitet të plotë kushtetues për shkak se është nxjerrë në ndjekje të një qëllimi legjitim kushtetues duke respektuar parimin e proporcionalitetit, duke mos kufizuar në mënyrë të panevojshme liritë dhe të drejtat kushtetuese të asnjë komuniteti

në Kosovë dhe, në fund, duke ndjekur në plotni procedurat e kërkuara kushtetuese për nxjerrjen e një ligji të kësaj natyre.[137]

Në **rastin e Rrogave** bëhet fjalë për aktivizëm gjyqësor që ka legjitimuar në aspektin kushtetues një vendim individual të Qeverisë së Kosovës, vendimin për rritjen e rrogave, i cili, në mënyrë efektive, përbën aktivitet të palejuar normativ që i takon sferës së ligjvënies. Në këtë kontekst, në paragrafin 117 të Aktgjykimit, Gjykata ka vënë në dukje se:

"[…] dëshiron të theksojë se nuk është brenda fushëveprimit të saj që të vlerësojë apo të zëvendësoje politikat publike të përcaktuara nga organi legjislativ apo ekzekutiv. Parimi i ndarjes së pushteteve detyron Gjykatën që të respektojë përcaktimin e politikave nga organet gjegjëse kushtetuese. Vendimet themelore të politik-bërjes për qeverisjen e vendit duhet të merren nga organet kushtetuese me legjitimitet demokratik, përkatësisht nga Kuvendi dhe Qeveria. Ato organe - për shkak të natyrës së tyre dhe legjitimitetit demokratik - janë të thirrura për të përcaktuar dhe avancuar politikat buxhetore, ekonomike dhe sociale të vendit (**shih, GJEDNJ *mutatis mutandis, Dubska dhe Krejzova kundër Republikës Çeke* [OHM], § 175**)".[138]

Këtu, në një mënyrë arbitrare, Gjykata ka vënë barazimin në mes të ekzekutivit dhe ligjvënësit, duke e trajtuar një vendim qeverie që ka natyrën e aktit individual sikur ai të kishte qenë një normë e përgjithshme me bazë të qartë ligjore dhe kushtetuese. Në fakt, në këtë vend, qartë shihet barazimi i këtyre dy organeve kushtetuese, duke i cilësuar dyjat si "organe kushtetuese me ligjitimitet demokratik", në ndërkohë që i tillë është vetëm legjislativi. Sa i përket ekzekutivit, ndërkaq, nuk don shumë mend për të kuptuar se ai organ ka deficit demokratik, sipas vetë definimit të tij si organ ekzekutiv i veshur me pushtete diskrecionale që janë antipod i legjitimitetit demokratik. Vendimi për rritjen e rrogave, krejt natyrshëm, është parë nga Gjykata si një vendim normal në vijim të zbatimit të kompetencave kushtetuese të Qeverisë, në ndërkohë që përmbajtja e tij ka qenë e një akti juridik abstrakt me norma të karakterit të përgjithshëm. Akte të kësaj natyre nxjerr ligjvënësi, kurse qeveria vetëm për aq sa ato kanë të bëjnë me organizimin dhe funksionimin e brendshëm të ekzekutivit. Qartë shihet se vendimi për rritjen e rrogave efektivisht ka qenë një akt juridik me efekte të përgjithshme përtej organizimin dhe funksionimit të qeverisë, duke afektuar kategori të gjëra të të punësuarve (krejt gjyqtarët dhe sistemin e drejtësisë së Kosovës).

T'i kthehemi tani, në vijim sa më sipër, teknikës së parë, asaj të **përqafimit** (**deference**), si teknikë gjykimi ku reflektohet marrëdhënia e gjykatave kushtetuese me gjyqësorin e rregullt. Këtu vijnë në shprehje dy forma të manifestimit të kësaj teknike: forma **e drejta e gjallë** (**living law**) dhe parimi i **subsidiaritetit**.

Te situata e mbuluar me formën e **drejta e gjallë**, e cila ka lindur dhe është zhvilluar në **GJKIt** për t'u përhapur edhe në disa vende të tjera të Evropës,[139] fjala është për procedurat e **kontrollit incidental të kushtetutshmërisë**. Në këto procedura, gjykata kushtetuese

---

[137] *Rasti KO 120/16. Aktvendim për Papranueshmëri . Parashtrues: Slavko Simić dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës .Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, 1 shkurt 2017. Nr. ref.: RK1034/17. I ngjashëm me këtë rast ka qenë edhe **rasti KO 94/16**, në të cilin kërkesa e parashtruesve u refuzua si qartazi e pabazuar: në paragrafin 48 të Aktvendimit, Gjykata ka theksuar se argumentet dhe interpretimet e parashtruesve të kërkesës nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për të mbështetur pretendimin e tyre, se Ligji për AKKVP-në ("Ligjit për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës") është me interes vital për një komunitet të caktuar etnik në Kosovë dhe jo me interes të njëjtë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Cf. *Rasti KO 94/16. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Slavko Simić dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, nr. 05/L-010*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 25 tetor 2016. Nr. ref.: RK981/16.

[138] **Rasti i Rrogave**, fusnota nr. 83, **supra**, si dhe komentet tona aty.

[139] Maartje de Visser, *Constitutional Review in Europe: A Comparative Analysis,* fq. 289-290.

merr për bazë interpretimin e kryer nga gjyqësori i rregullt, përkatësisht injoron kuptimin që ka teksti i dispozitës juridike që është referuar për kontroll kushtetues dhe pranohet si i vlefshëm interpretimi e atij teksti ashtu siç është kryer nga gjykata referuese. Kjo teknikë interpretimi ka lindur si rezultat i dallimit të cilin **GJKIt** e bën në mes të **disposizione** (teksti) dhe **norma** (interpretimi) në procedurat e kontrollit incidental të kushtetutshmërisë së normave juridike. Në këto procedura, të cilat dominojnë vëllimin e punës në gjyqësinë kushtetuese italiane, gjykata referuese çdoherë duhet të formulojë një interpretim të tekstit të dispozitës që dërgohet (referohet) për kontroll kushtetues të kushtetutshmërisë. Në të njëjtën kohë, gjykata referuese duhet të tregoj edhe interpretimin mbizotërues të po asaj dispozite që ekziston në praktikën gjyqësore të gjyqësorit të rregullt.[140]

E ngjashme me praktikën e bazuar në **diritto vivente** të Italisë është praktika që mbështetet në respektimin e **parimit të subsidiaritetit**. Kjo teknikë manifestohet në dy forma: e para formë ka të bëjë me procedurat në ankesat individuale kurse e dyta lindë në procedurat e kontrollit abstrakt të normës (qoftë ai kontroll preventiv ose represiv, abstrakt apo incidental). Në rastin e procedurave lidhur ankesat individuale, gjykatat kushtetuese nuk gjykojnë lidhur me interpretimet e normave që i kanë kryer gjykatat e rregullta. Në rastet kur një interpretim i tillë ka çuar në shkelje kushtetuese, gjykatat kushtetuese i vejnë në spikamë të njëjtat duke i rikthyer çështjet në gjykatën përkatëse shkelëse me udhëzim dhe urdhër për ndreqje të tyre sipas parametrave kushtetues të shënuar në aktgjykimin e gjykatës kushtetuese. Parimi njëjtë vlen edhe për **GJEDNJ** dhe për **Gjykatën Evropiane të Drejtësisë** (**GJED)** kundrejt punës dhe interpretimeve të kryera nga gjykatat nacionale: shkeljet e **KEDNJ** apo të rregullativës së **BE**-së duhet të ndreqen sipas udhëzimeve dhe urdhrave të shënuara në vendimin e këtyre dy gjykatave evropiane.

Në rastin e procedurave për kontroll abstrakt, ndërkaq, **parimi i subsidiaritetit** konsiston në atë se gjykatat kushtetuese nuk futen në normëvënie apo në ndërtim të interpretimeve normative. Një detyrë e tillë i lihet ligjvënësit për ta kryer. Ngjashëm vepron edhe **Gjykata në Strasburg** kur gjykon lidhur me shkeljet e **KEDNJ**. Po ashtu, situatë e njëjtë na paraqitet me **GJED (**në rastin e procedurave të kontrollit preliminar apo të kontrollit incidental të iniciuara nga gjykatat nacionale respektive lidhur me zbatimin në nivel nacional të **Traktatit të Lisbonës** të vitit 2009 dhe rregullativës tjetër të **BE**-së që buron nga ky traktat dhe nga burimet tjera primare të saj).

Teknika e dytë, e a.q. teknika e **interpretimit konform-kushtetutës** (**constitution-conform interpretation**), paraqet teknikën që më së shumti shkakton aktivizëm gjyqësor. Në kontekst të zbatimit të kësaj teknike, në literaturë është folur si për një **kirurgji gjyqësore**

[140] Në praktikën gjyqësore kushtetuese në Itali janë kristalizuar disa forma të vendimeve që prodhohen me rastin e përdorimit të doktrinës së të drejtës së gjallë (**diritto vivente**). Në të gjitha rastet bëhet fjalë për vendime të dhëna në procedurat e kontrollit incidental që, siç u tha, përbëjnë juridiksionin që identifikon **GJKIt**.
I pari ndër to janë aktgjykimet korrigjuese (**sentenze di correzione).** Këtu **GJKIt** nuk i shqyrton fare meritat e rastit, duke e refuzuar interpretimin e propozuar nga gjyqtari apo gjykatat e rregullt referuese. Në këtë rast, ajo lë në fuqi interpretimin ekzistues të normës së referuar për kontroll kushtetues incidental, duke i sugjeruar gjykatës apo gjyqtarit referues që të ngjitet pas interpretimit ekzistues, jo të bëj interpretim tjetër vetanak. Forma e dytë janë vendimet interpretative (**sentenze interpretative**), të cilat marrin dy forma: **sentenca interpretativa di rigetto** dhe **sentenza interpretativa di accoglimento**. Në rastin e parë bëhet fjalë për refuzim nga ana e **GJKIt** për të shpallur si jokushtetues një dispozitë të një norme apo ligji të referuar për kontroll incidentat kushtetues. Në këto raste, thënë ndryshe, ajo nuk pajtohet me propozimin e gjyqtarit apo gjykatës referuese sipas së cilëve norma apo ligji i kontestuar është jokushtetues. Në të dytin rast, ndërkaq, ndodhë e kundërta me këtë: **GJKIt** pajtohet me gjyqtarin apo gjykatën referuese se dispozita e referuar është jokushtetuese ashtu siç ka menduar gjakatari apo gjykata referuese, përfshirë këtu edhe dispozitat që kanë të bëjnë me të drejtën e gjallë (**living law**), duke e ndryshuar me këtë rast normën apo praktikën që është bazuar në interpretimin e llojit të së drejtës së gjallë (**living law**), por duke e lënë në fuqi dispozitën apo tekstin ekzistues. Cf. Maartje de Visser, *Constitutional Review in Europe: A Comparative Analysis,* fq. 286-287; Shih po ashtu edhe Giancarlo Rola & Tania Groppi, "Between Politics and law: The Development of Constitutional Review in Italy". Në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West,* fq. 143-159.

të normave juridike, të cilën e kryejnë gjykatat kushtetuese gjatë kontrollit kushtetues abstrakt.[141] Në **doktrinën franceze**, kjo teknikë ndryshe quhet ***réserves d'interprétation.***[142] Esenca te kjo teknikë konsiston në atë se norma juridike nuk anulohet. Ajo lejohet të vazhdojë jetën e vet, mirëpo në mënyrën e përcaktuar nga gjykata kushtetuese me vendim.[143] Kjo do të thotë se norma juridike shpallet jokushtetuese por nuk anulohet, duke e lënë atë në regjistrat juridik (**gazeta/fletore zyrtare**) për një kohë të caktuar, sipas udhëzimeve të përcaktuara nga gjykata kushtetuese. Kjo teknikë është shumë e përhapur në **Evropë** dhe përtej, në vendet ku ka gjyqësi të ndarë kushtetuese. Në fakt, është shumë më e përhapur se teknika e parë e diskutuar më sipër.[144]

Në ndërkohë që teknika e parë reflekton standardin klasik kelsenian të gjyqësisë kushtetuese si **ligjvënës negativ**, siç e diskutuam më sipër, teknika e dytë, përkatësisht teknika e **interpretimit konform-kushtetutës** (**constitution-conform interpretation**) sikur lë përshtypjen se bëhet fjalë për respektim të sovranitetit të ligjvënësit si përfaqësues i sovranit nga ana e gjykatave kushtetuese. Kjo përshtypje krijohet nisur nga fakti se përpjekjet e gjykatave kushtetuese, të cilat zbatojnë këtë teknikë, për qëllim themelor kanë shpëtimin e normës juridike nga anulimi. Ky fakt, vetëm në shikim të parë krijon përshtypjen se fjala është për ruajtjen e sovranitetit të ligjvënësit. Kjo, megjithatë, nuk është e saktë: në përpjekje për të ruajtur këtë sovranitet të ligjvënësit, në rrugë e sipër me qëllim të respektimit të dinjitetit të tij, gjykatat kushtetuese angazhohen në operacione silogjistike të karakterit normativ, të cilat, sikundër u tha, kanë natyrë të një **intervenimi kirurgjik** në normën juridike fillestare të prodhuar nga ligjvënësi.

Sado që mund të duket paradoksale, kjo teknikë, për dallim nga ajo e para, përkatësisht për dallim nga teknika e **përqafimit** (**deference**), ka lindur në vijim të përpjekjeve të gjykatave kushtetuese për të ruajtur sovranitetin e ligjvënësit në sferën e normëvënies. E përbashkëta e këtyre dy teknikave konsiston në faktin se të dyja kanë lindur në përpjekjet e gjykatave kushtetuese për të ruajtur dinjitetin e përfaqësuesit të sovranit në sferën e normëvënies apo, shikuar nga këndi i gjyqësisë kushtetuese, në përpjekjet për të ruajtur identitetin e gjykatave kushtetuese si **ligjvënës negativ**. Në praktikë, megjithatë, vetëm teknika e parë e arrin këtë qëllim, në ndërkohë që teknika e dytë kalon dukshëm në sferën normative apo në sferën e **ligjvënësit pozitiv**, pikërisht për shkak të përpjekjeve të gjykatave kushtetuese për të respektuar sovranitetin dhe dinjitetin e integritetin e përfaqësuesit të sovranit.

Parimi themelor që mishëron këtë teknikë interpretimi, e cila prodhon **ligjvënie pozitive**, sërish ka të bëjë me respektimin e **prezumimit të kushtetutshmërisë së ligjeve**. Këtu, megjithatë, kahja e aktivitetit gjyqësor është e theksuar aktiviste dhe krejt e kundërt me

---

141 Maartje de Visser, *Constitutional Review in Europe: A Comparative Analysis*, fq. 282, 292.

142 Sipas doktrinës franceze, e cila bazohet në studimin e praktikës së **Këshillit Kushtetues**, rezervat zakonisht marrin tri forma . E para formë njihet si **reserves constructives** (formë në të cilën Këshilli fut disa fjalë në tekstin e normës apo të ligjit me qëllim që ato të bëhen në përputhshmëri me atë që në Francë njihet si **bloc de constitutiutionalite**, për çka kemi bërë fjalë në seksionin 2.2 të kapitullit të dytë të librit, si dhe në këtë kapitull: cf. fusnota nr. 64, **supra**, si dhe komentet tona aty. Forma e dytë cilësohet si **reserves neutralisantes** (ku Këshilli i fshinë efektet e dëmshme të dispozitave të kontestuara duke shënuar se ato janë pa efekt legal). Në fund, si formë e tretë, janë **reserves directives** (ku Këshilli tregon se si ata që duhet të zbatojnë normat apo ligjet e kontestuara, në rend të parë gjykatat e rregullta, duhet të zbatojnë të njëjtat në praktikë). Cf. më shumë për këtë në: Alexandre Viala, *Les réserves d'interprétation dans la jurisprudence du Conseil constitutionnel*. Tome 92 (LGDJ: Paris, 1999) (në këtë tezë prej 336 faqesh, autori jep në mënyrë të zgjedhuar historikun e lindjes së kësaj teknike juridike dhe parametrat mbi të cilat është ndërtuar praktika e interpretimit nën rezerva në përvojën e Këshillit, me vështrim të veçantë në parametrat e përfshirë në **bloc de constitutionalite**); Julien Bonnet,"Les instruments du contrôle de constitutionnalité". *La Revue administrative* 56e Année, No. 335 (Septembre 2003), fq. 488-490; Bertrand Mathieu, "Le Conseil constitutionnel "législateur positif" ou la question des interventions du juge constitutionnel français dans l'exercice de la fonction legislative" *Revue internationale de droit comparé* Vol. 62 No. 2 (2010) fq. 507-553.

143 Maartje de Visser, *Constitutional Review in Europe: A Comparative Analysis*, fq. 292.

144 Ibid. fq. 292-305 (ku autori flet gjerësisht për përvojat gjyqësore të gjyqësisë kushtetuese në **Belgjikë**, Çeki, **Gjermani** dhe **Spanjë**).

ligjvënien negative të përshkruar si më sipër. Duke ndjekur këtë parim, që mishëron **prezumimin e kushtetutshmërisë së ligjeve**, gjykatat kushtetuese kanë ndërtuar **teknikën e interpretimit konform kushtetues (constitution-conform interpretation)**. Varianti i parë i kësaj teknike bazohet në logjikën se norma juridike e përmbajtur në një ligj apo akt tjetër të përgjithshëm duhet të këtë mundësi leximi ndryshe nga leximi që del si jokushtetues kur lexohet për herë të parë, përkatësisht mundësi leximi në pajtim me kushtetutën. Kjo mundësi buron nga fakti i thjeshtë se metoda kryesore e interpretimit është ajo që bazohet në tekst dhe në gjuhë, të cilat çdoherë kanë mundësi që të prodhojnë më shumë se një kuptim, njëri prej të cilëve është në pajtim me kushtetutën. Varianti i dytë, ndërkaq, nuk bazohet në gjuhën dhe tekstin por në kontekstin, objektin dhe qëllimin e normës juridike që gjendet në një ligj apo në ndonjë akt tjetër të përgjithshëm. Shikuar nga ky këndvështrim, kjo teknikë juridike përbën shtratin e aktivizmit të vërtetë gjyqësor sepse në disa raste gjykatat duhet të heqin fjalë apo fjali të tëra nga teksti (**lexim i ngushtë i normës**) e në disa të tjera ato duhet të shtojnë fjalë apo fjali të tëra me qëllim që norma juridike të sillet në pajtim me kushtetutën (**lexim i gjerë i normës**).

Si në rastin e parë, ashtu edhe në të dytin, gjykatat kushtetuese japin udhëzime për mënyrën e leximit. Ato udhëzime jepen për organet tjera, gjyqësorin në rend të parë, lidhur me mënyrën se si norma juridike e modifikuar nga gjykata kushtetuese duhet të zbatohet nga gjykatat e rregullta, administrata shtetërore dhe nga akterët tjerë shtetërorë të cilëve iu referohet (adresohet) ajo. Në këtë kuptim, ta zëmë, një normë ligjore mund të thotë se përfitimet për fëmijët (shtesat e fëmijëve) i marrin vetëm prindërit në martesë të ligjshme. Në një rast të tillë, gjykata kushtetuese mund të shtoj një fjali që thotë se, pas presjes, përfitimet apo shtesat e fëmijëve u takojnë edhe atyre prindërve që kanë bashkësi jashtëmartesore. Në mënyrë të ngjashme, por anasjelltas, norma juridike mund të thotë se përfitimet apo shtesat e fëmijëve nuk u takojnë fëmijëve jashtëmartesor, kurse gjykata në formulimin e saj të ri përcakton se, në pajtim me normën kushtetuese, norma e tillë ligjore duhet të lexohet ashtu që përfitimet apo shtesat e fëmijëve u takojnë edhe fëmijëve jashtëmartesor.

14.5. Vetëpërmbajtja gjyqësore

E kundërt me teknikën aktiviste të interpretimit është ajo e **vetëpërmbajtjes gjyqësore**. Edhe kjo mënyrë gjykimi, në kuptimin material (substancial) të fjalës, bazohet në premisën fillestare të prezumimit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjera të autoriteteve publike. Me këtë nënkuptohet se, në parim, gjyqtarët kushtetues nuk kanë paragjykime ndaj përmbajtjes së normave të përgjithshme dhe akteve individuale konkrete të autoriteteve publike, përfshirë këtu aktet e gjyqësorit. Esenca e kësaj praktike në gjykim niset nga prezumimi sipas së cilit rendi juridik prodhon norma të përgjithshme që janë kushtetuese dhe, në vijim të zbatimit të tyre, organet shtetërore dhe organet tjera publike veprojnë në bazë të kushtetutës dhe ligjit. Për dallim nga prezumimi i kushtetutshmërisë i sqaruar në seksionin paraprak, këtu prezumimi nuk prodhon **aktivizëm gjyqësor**, por të kundërtën e saj – **vetëpërmbajtjen gjyqësore**.

E parë nga këndvështrimi i material (substancial), **vetëpërmbajtja gjyqësore** nënkupton dy gjëra themelore. Në rend të parë, gjyqtarët kushtetues respektojnë autoritetin e organeve shtetërore dhe organeve tjera publike për normëvënie dhe nxjerrje të akteve tjera juridike në vijim të ushtrimit të autorizimeve të tyre kushtetuese, ligjore dhe autorizimeve tjera të bazuara në kushtetutë dhe ligj. Në këtë kontekst, ky respektim supozohet të jetë maksimal. Së dyti, në të njëjtën kohë, kjo do të thotë se gjyqtarët kushtetues anulojnë aktet juridike (të përgjithshme dhe individuale) vetëm në rastet jashtëzakonisht të dukshme të shkeljeve kushtetuese. Në terma praktik, kjo më tutje nënkupton që gjyqtarët kushtetues, jo vetëm që nuk zëvendësojnë pikëpamjet e tyre me ato të organeve tjera shtetërore, por edhe kujdesen që të prononcohen vetëm për ato çështje kushtetuese që janë më se të domosdoshme për vendosjen e kërkesës kryesore, duke lënë shumë gjëra të pathëna sa i përket pjesëve të tjera të aktit (të përgjithshëm

apo individual) që ka qenë objekt kontrolli kushtetues. Në këtë lloj teknike të interpretimit, jo vetëm që nuk ekziston një **obiter dicta**, por edhe vetë arsyetimi i dispozitivit të vendimit (verdiktit) paraqitet si shumë i qartë, i prerë dhe pa dykuptimësi.

Për dallim nga **aktivizmi gjyqësor**, që në të shumtën e kohës asocon me diçka negative dhe të dëmshme, **vetëpërmbajtja gjyqësore** bën kundërtën: gjyqtarët këtu, jo vetëm që nuk thonë asgjë, por as nuk gjykojnë (vendosin) më shumë se që kërkohet nga ta me dispozita kushtetuese, ligjore, rregulla të brendshme dhe nga specifikat e tjera të rastit. Në shikim të parë kjo duket sikur përbën një teknikë pune në respektim të kushtetutës, ligjit dhe bazave të tjera juridike të vendimmarrjes. Si e tillë, kjo teknikë nuk duket se paraqet rrezik për marrëdhënien në mes të pushteteve, përkatësisht në mes të organeve kushtetuese që ushtrojnë ato pushtete. Kjo, megjithatë, vetëm në dukje është kështu: **vetëpërmbajtja gjyqësore** përbën një rrezik shumë më të madh se **aktvizmi gjyqësor**, i përshkruar si më lartë. Ky rrezik është i njëjtë në të gjitha format kryesore të manifestimit të gjyqësisë kushtetuese, siç janë, ta zëmë, gjykimet për kërkesat që kanë të bëjnë me ndarjen dhe balancimin e pushteteve, kontrollin abstrakt të normës juridike dhe, së fundi, anekset kushtetuese që kanë për objekt mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të garantuara me kushtetutë. E njëjta vlen edhe për format tjera të ushtrimit të gjyqësisë kushtetuese, siç janë, ta zëmë, kontrolli kushtetues i referendumeve, partive politike, gjykimet penale të funksionarëve të larët shtetëror, etj. Të shohim përciptazi si duket vetëpërmbajtja gjyqësore vetëm sa i përket tri rasteve të sipërme të ushtrimit të gjykimit kushtetues (kontrolli abstrakt i normës, ndarja dhe balancimi i pushteteve dhe ankesa kushtetuese).

Në rastin e parë, **vetëpërmbajtja gjyqësore** rezulton në **abstenim**, i cili domosdo shkakton **abdikimin** e gjyqtarëve kushtetuese nga ushtrimi i juridiksionit të tyre, qëllim i të cilit është sigurimi i supremacisë (epërsisë) së kushtetutës duke detyruar secilin organ kushtetues që të ushtrojë pushtetin shtetëror dhe autoritetin tjetër publik brenda kuadrit të përcaktuar kushtetues.[145] Ky abstenim me pasojë abdikimin nga dhënia e verdiktit kushtetues hap rrugë për ushtrim të despotizmit nga ana e organit **uzurpator** të kompetencave të organeve të tjera, përkatësisht hap rrugë për nënshtrim jokushtetues të një organi ndaj organeve të tjera që kanë uzurpuar kompetencat e tjerëve në mënyrë jokushtetuese. Kjo situatë rrënon parametrat matës kushtetues mbi sundimin e ligjit në qeverisjen shtetërore. Si e tillë ka të bëjë, **mutatis mutandis**, jo vetëm me kërkesat që kanë për objekt zgjidhjen e një konflikti konkret për kompetencë dhe kontrollin abstrakt të normave juridike, por edhe me të gjitha rastet e kërkesave të tjera që për objekt kontrolli kushtetues i kanë aktet tjera juridike përveç ligjit (qofshin në natyrës së përgjithshme apo individuale) apo **emetimet** (lëshimet) kushtetuese të organeve që me kushtetutë e ligj kanë në ngarkesë aktivitete të caktuara normëvënëse apo vendimmarrëse.

Në rastin e dytë, si vendime të përshtatshme për ushtrim të **vetëpërmbajtjes gjyqësore** paraqiten normëvëniet që kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat e njeriut. Në këto raste gjykatat kushtetuese duhet të bëjnë balancimin në mes të dy interesave në konflikt me njëri tjetrin, interesa që përbëjnë esencën e të drejtës apo lirisë që rregullohet me norma juridike. Kjo në veçanti vlen për liritë dhe të drejtat njerëzore rreth të cilave nuk ka konsensus shoqëror (si p.sh. çështja e **abortit**, çështja e bartjes së **shamive** dhe **simboleve fetare** nëpër shkolla dhe hapësira të tjera publike dhe kështu me radhë). Në këto raste, gjykatat nuk mund të rrinë indiferente dhe të abstenojnë nga dhënia e përgjigjes në pyetjen se cili nga interesat në konflikt që përbëjnë esencën e lirisë dhe të drejtës për të cilën vendoset është me fuqi më të madhe kushtetuese. Kështu është edhe në **Kosovë** dhe këtë e sanksionon neni 55 [“Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore”] i Kushtetutës, ku përcaktohet në mënyrë të qartë dhe në formë të urdhrit kushtetues detyrimi për balancim në të gjitha situatat kur vlerësohet preponderanca e një interesi kundrejt një tjetri interes. Ky nen shërben si udhëzues dhe orientues për ligjvënësin, Kuvendin e Kosovës, për çdo normëvënie të tij që mëton të kufizoj liritë dhe të drejtat e njeriut të garantuara me Kushtetutë.

[145] Abdikimi nga gjykimi i rastit apo i zgjidhjes së mosmarrëveshjes përbën një mohim të drejtësisë (**deni de justice**) që nuk duhet as të lejohet e as të tolerohet. Cf. më shumë për këtë në Lawrence A. Alexander, “Judicial Activism: Clearing the Air and the Head”. Në Luís Pereira Coutinho, Massimo La Torre & Steven D. Smith (eds.), *Judicial Activism. An Interdisciplinary Approach to the American and European Experiences*, fq. 15-20.

Si hap i parë në procesin e balancimit që kryhet gjatë vlerësimit të peshës kushtetuese të dy a më shumë interesave në konflikt me njëri tjetrin është konstatimi se akti normëvënës kufizues i lirive dhe të drejtave njerëzore ka natyrën e normës abstrakte ligjore. Kjo thuhet qartë në paragrafin e parë të nenit 55 si më sipër të Kushtetutës. Me natyrë abstrakte ligjore, sipas standardeve evropiane, nënkuptohet edhe akti juridik që nuk ka formën e ligjit por që prodhon pasoja juridike për subjektët e së drejtës, në këtë rast prodhon kufizim të lirive dhe të drejtave individuale të garantuara me Kushtetutë. I dyti hap në vijim konsiston në atë se kufizimi si më sipër duhet të jetë i domosdoshëm për arritjen e qëllimit të caktuar legjitim. Kjo do të thotë se kufizimi nuk mund t'i shërbej asnjë qëllimi tjetër pos atij të përcaktuar me ligj, ashtu siç përshkruhet në paragrafin e tretë të nenit 55 si më sipër. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, thuhet në paragrafin e katërt të këtij neni, të gjitha institucionet e pushtetit publik, sidomos normëvënësi, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël. Kjo përfundimisht nënkupton se, siç thuhet në paragrafin e fundit të nenit në fjalë, kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrsesi esencën e së drejtës së garantuar. Kjo nënkupton detyrim për Kuvendin e Kosovës që, me rastin e normëvënies, të ketë shumë kujdes për kufizimet e lirive dhe të drejtave kushtetuese: ato duhet të jenë të qarta, të sakta dhe të përshkruara mirë ashtu që zbatuesit e normave të mos kenë dilema rreth kuptimit të saktë të përmbajtjes së tyre.

Procesi i balansimit të interesave publike dhe private nuk vlen vetëm për normëvënësin, Kuvendin e Kosovës. Në mënyrë të njëjtë kjo vlen edhe për gjyqësorin, i cili duhet të zbatoj testin e proporcionalitetit në secilin rast apo mosmarrëveshje konkrete. Kjo nënkupton se tërë ky proces balancimi ekziston për të shërbyes si një shtyllë e fortë kundër vetëpërmbajtjes gjyqësore. Vënia në jetë e parimit të proporcionalitetit, përveç që është shtyllë kundër vetëpërmbajtjes gjyqësore, ai në të njëjtën kohë shërben si barrierë kundër aktivizmit gjyqësor. Kjo shihet qartë në praktikën gjyqësore kushtetuese komparative dhe është reflektuar në praktikën e Gjykatës Kushtetuese në Kosovë. Në vijim diskutojmë shkurt, për qëllime ilustrimi, disa nga rastet e **vetëpërmbajtjes gjyqësore** në të cilat është reflektuar respekti për parimin e proporcionalitetit, i përshkruar si më sipër.

Në **rastin e Veteranëve** të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Gjykata ka pasur për objekt vlerësimin e kushtetutshmërinë e **Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.**[146] Në paragrafët 76, 90 dhe 123, **inter alia**, vjen në shprehje aplikimi i testit të proporcionalitetit.

Në paragrafin e 76, Gjykata ka thekuar se Qeveria dhe Kuvendi gëzojnë një margjinë të vlerësimit të lirë kur vlerësojnë, nëse dhe deri në çfarë mase dallimet në situata të tjera të ngjashme justifikojnë një ndryshim në trajtim. Fushëveprimi i kësaj margjine ndryshon sipas rrethanave, sipas objektit të çështjes dhe sipas historisë së rastit. Një margjinë e gjerë zakonisht lejohet kur është fjala për masa të përgjithshme të strategjisë ekonomike apo sociale, përveç nëse ato janë qartazi pa asnjë bazë të arsyeshme. Për të provuar këtë konstatim të saj, Gjykata ka cituar në paragrafin e sipërm raste nga praktika e **Gjykata e Strasburgut**: rastin **Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar**, kërkesa nr. 13378/05, datë 29 prill 2008, paragrafi 60 i vendimit të, si dhe rastin **Khamtokhu dhe Aksenchik kundër Rusisë**, paragrafi 64 i vendimit".

Nëse është plotësuar kriteri i kufizimit me ligj të lirive dhe të drejtave të njeriut, Gjykata ka treguar në paragrafin 90 të vendimit të saj si më sipër. Lidhur me këtë, ajo ka vërejtur se kufizimi i pretenduar i të drejtës së veteranëve të **UÇK**-së për pension është paraparë me nenin 3 (2) të ligjit të kontestuar të miratuar nga Kuvendi, i cili është institucioni shtetëror të cilin Kushtetuta e ka veshur me ushtrimin e pushtetit legjislativ. Kjo, sipas Gjykatës, paraqet një kufizim që është në përputhje me kërkesat e përfshira në

[146] *Rasti KO 01/17. Aktgjykim. Parashtrues: Aida Dërguti dhe 23 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, 4 prill 2017. Nr. ref.: AGJ1053/17.

nenin 55 (1) të Kushtetutës. Për këtë arsye, thotë Gjykata në të njëjtin paragraf, kufizimi i të drejtës së veteranëve të **UÇK**-së për pension është paraparë me ligj. Pjesë e këtij vlerësimi është edhe analiza në paragrafin 123 të aktgjykimit, në të cilin Gjykata ka rikujtuar se ligjvënësi gëzon diskrecion të caktuar për të vendosur lidhur me masat për arritjen e objektivave specifike dhe, sigurisht, nuk i takon asaj të zëvendësojë vlerësimin e bërë nga autoritetet relevante me vlerësim të vetin, lidhur me atë se cila mund të jetë politika më e mirë në këtë fushë. Të marra së bashku, vlerësimet në tre paragrafët e mësipërm të aktgjykimit përbëjnë në mënyrë kumulative esencën e parimit të proporcionalitetit, si shtyllë frenuese e aktivizmit gjyqësor, por edhe si një themel për ushtrimin e **vetëpërmbajtjes gjyqësore**.

Një rast tjetër me rëndësi për të parë teknologjinë e ushtrimit të vetëpërmbajtjes gjyqësore nga ana e **Gjykatës Kushtetuese** është **rasti Trepça**, i përmendur më sipër.[147] Në tre paragrafët e aktvendimit që diskutohen në vijim, paragrafët 56-58, Gjykata manifeston **vetëpërmbajtje gjyqësore** në një mënyrë të theksuar, duke mos pranuar të substituojë (zëvendësojë) pikëpamjet e veta me ato të ligjvënësit kosovar sa i përket arsyeshmërisë dhe dobishmërisë së nxjerrjes së ligjit që ka qenë objekt i kontrollit kushtetues, **Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën.**

Në paragrafin 56 të aktvendimit, Gjykata nënvizon qëllimet e ligjit objekt kontrolli, që janë krejtësisht të natyrës objektive dhe zhvillimore për interes të përgjithshëm. Paragrafi në vijim konstaton se këto objektiva të përgjithshme zhvillimore nuk kufizohen vetëm për njërin komunitet kosovar, por janë me interes të përgjithshëm publik dhe kanë për qëllim mirëqenien e tërë shoqërisë. Në të fundit prej tre paragrafëve që mishërojnë vënien në jetë të testit të proporcionalitetit në ushtrimin e vetëpërmbajtjes gjyqësore, Gjykata vendos se kërkesa e parashtruesve është e palejueshme pikërisht për shkak të faktit se, përveç që shumë nga njësitë biznesore të prekura gjenden në komunat me shumicë serbe dhe punësojnë shumë serbë të Kosovës, parashtruesit kanë dështuar të dëshmojnë se si dhe përse konkretisht do të dëmtohej komuniteti serb i Kosovës me nxjerrjen e **Ligjit për Trepçën**.

I po kësaj natyre është edhe **rasti i Imuniteteve**, i diskutuar më sipër nga këndvështrimi i **ligjvënësit negativ.**[148] Në këtë rast, vetëpërmbajtja gjyqësore manifestohet në mbështetjen e fuqishme që Gjykata e ka bërë në zbatimin e parimit të proporcionalitetit për të parë nëse ligji objekt kontrolli kushtetues kishte ndjekur një qëllim legjitim. Për këtë arsye, në vijim japim në tërësi paragrafët relevantë, në mënyrë që lexuesi ynë të sheh si duket ky ushtrim i vetëpërmbajtjes gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese. Fjala është për këto paragrafe të aktgjykimit në **rastin e Imuniteteve:**

"[…] **52.** Gjatë vlerësimit të kësaj kërkese, Gjykata duhet të ketë parasysh se në përgjithësi i tërë **legjislacioni supozohet të jetë kushtetues, derisa nuk dëshmohet ndryshe**. Mandati i Gjykatës është vetëm ta vlerësojë kushtetutshmërinë e një vendimi ose akti legjislativ, **e jo ta vlerësojë ligjshmërinë e tij ose nëse ai mbështetet me politikë të mire publike.** (Shih nenin 112 te Kushtetutës).

54. Ka kufizime në të drejtën ose autoritetin e Kuvendit për të miratuar legjislacion: *[…](1) Legjislacioni duhet të jetë në pajtim me Kushtetutën dhe parimet e Kushtetutës;*

(2) Legjislacioni që ndikon në individë, korporata apo persona, ***duhet të ketë synim legjitim dhe duhet të jetë në proporcion*** *me të drejtat e të gjithë qytetarëve të Kosovës.*

(3) Legjislacioni që u ofron përfitim të drejtpërdrejtë të posaçëm anëtarëve të Parlamentit, duhet të bazohet në arsyet që mbështeten me ***qëllime të qarta dhe legjitime publike****.*

55. Legjislacioni i kontestuar duhet te analizohet pikërisht mbi këtë bazë. A i ka marre parasysh Kuvendi këto parime kur e ka miratuar këtë ligj, dhe a ka përcaktuar se cili ishte qëllimi legjitim i këtij

147 *Rasti KO 118/16. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Slavko Simić dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 31 Tetor 2016 Nr. ref.:RK986/16.

148 Cf. fusnota nr. 135 & 136, **supra**, si dhe komentet tona aty.

ligji? N**uk ka prova në këtë Gjykatë që sugjerojnë se Kuvendi e përdori atë analizë me rastin e miratimit të këtij legjislacioni.**

79. Gjykata, gjithashtu duhet të vërejë se Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, duke përcaktuar pensione në shkallë prej 50%, 60%, dhe 70% të pagës aktuale bazë të deputetit, ka caktuar pensione që do të jenë 8 -10 herë më të larta se pensionet bazë që gjithashtu paguhen nga Buxheti i Kosovës. Disproporcioni i tillë në lidhje me moshën e pensionimit, dhe shuma e pensionit në krahasim me pensionin bazë, **pa kurrfarë arsyetimi për qëllimet që synohen të arrihen,** ngritin pyetje serioze nëse Kuvendi i ka marre parasysh nenet 7, 3 dhe 24 të Kushtetutës së Kosovës kur e ka miratuar këtë ligj.

80. Gjatë kohës së miratimit ose pas miratimit të tij, Kuvendi i Kosovës nuk ka ofruar shpjegim të arsyeshëm lidhur me "qëllimin legjitim që e ka ndjekur" me rastin e miratimit të legjislacionit që kontestohet nga Avokati i Popullit. **Pa një arsyetim të tillë, ky legjislacion e humb supozimin e përgjithshëm se është kushtetues dhe në pajtim me Kushtetutën.** Në të vërtetë, nga procesverbali i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, duket se **OSBE**-ja kishte rekomanduar fuqishëm qe ky legjislacion te mos aprovohej dhe, së paku, një anëtar i Kuvendit kishte sugjeruar se nuk ishte koha e duhur për ta miratuar një legjislacion të tillë. Përkundër këtyre kundërshtimeve, ky legjislacion u miratua pa ndonjë shpjegim, apo arsyetim a koment, nga ministri i Financave apo Banka Qendrore lidhur me ndikimet fiskale apo ekonomike që ka miratimi i këtij ligji.

82. Vendimi i Gjykatës **nuk e ndalon Kuvendin** që të miratojë legjislacion për pensione për deputetë të Kuvendit, as që e ndalon Kuvendin që të miratojë legjislacion për kompensimin e familjeve të deputetëve të Kuvendit me shumë përkatëse, nëse deputeti vdes apo lëndohet gjersa shërben si deputet, **nëse Kuvendi i ka parasysh kriteret e Kushtetutës me rastin e miratimit të legjislacionit të tillë**".

Në rastin e tretë të **vetëpërmbajtjes gjyqësore**, për dallim nga rastet e aktivizmit gjyqësor, e keqja paraqitet edhe më e madhe. Kjo është kështu sepse, gjyqësinë kushtetuese, si instancë e fundit për ndreqjen e shkeljeve kushtetuese dhe sigurimin e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës, e komprometon dhe e bën të paefektshme në sytë e qytetarit. Kjo në veçanti vlen për vendet që kultivojnë **ankesën e plotë** apo **gjysmë të plotë** kushtetuese. I tillë është rasti, ta zëmë, me **Gjermaninë**, **Kosovën**, disa vende ish-komuniste evropiane, vendet e caktuara në **Amerikë Latine** dhe **Azi Jug-Lindore**, të cilat modelohen sipas sistemit gjerman të ankesës së plotë kushtetuese. Në këto vende anekse kushtetuese përbën një mjet efektiv, që do të thotë se ajo paraqet instancën dhe mundësinë e fundit për korrigjim të gabimet e degëve tjera të pushtetit në sferën e shkeljeve kushtetuese të lirive dhe të drejtave individuale.

Në fund meriton të thuhen dy-tri fjalë për sferën procedurale të manifestimit të **vetëpërmbajtjes gjyqësore**, nisur nga fakti se ajo manifestohet në secilin aspekt të vlerësimit të lejueshmërisë së rastit për gjykim dhe vendose meritore, me fillim që nga shterja e mjeteve juridike si një standard i qartë kushtetues, nëse pala ka legjitimitet pasiv, status të palës së privilegjuar (shefi i shtetit, qeveria, kuvendi, avokati i popullit etj.) e deri te vlerësimi nëse kërkesa është në themel të saj një kërkesë qartazi e pabazuar. Në këtë kuptim, në **Kosovë** dhe sipas praktikës së gjykatave të tjera kushtetuese në **Evropë**, deri te **vetëpërmbajtja** vjen kryesisht në lëndët apo kërkesat që kanë të bëjnë me **ankesat individuale**. Si rast i parë i manifestimit të vetëpërmbajtjes gjyqësore në sferën jomeritore, në praktikën e Gjykatës Kushtetuese paraqitet **Rasti i RTK**-së: në paragrafët 45-46 të **Vendimit për Heqjen nga Lista**,[149] Gjykata flet për **vetëpërmbajtjen gjyqësore** në rastet kur bëhet çregjistrimi i kërkesës për shkak se ajo nuk ka më objekt për shqyrtim dhe vendosje (çështja në ndërkohë është zgjidhur vetvetiu ashtu që më nuk ka objekt shqyrtimi).

Një rast tjetër i rëndësishëm në sferën procedurale të vetëpërmbajtjes gjyqësore, e cila në fakt nuk është e tillë, paraqet edhe **anulimi i cilësisë së palës së privilegjuar të shefit të shtetit dhe qeverisë jashtë juridiksionit material** nga neni 113. parag. 2 & 3 ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] i Kushtetutës.

[149] Cf. fusnota nr. 134, **supra**, si dhe teksti që e shoqëron me komentet rreth saj.

Ky autorizim në dobi të këtyre dy organeve kushtetuese ka ndodhur me vendim meritor, me aktgjykim, dhe ka qenë rezultat e aktivizmit gjyqësor të **Gjykatës Kushtetuese**. Në shikim të parë, ndryshimi i kësaj praktike me vendim jo-meritor, **aktvendim**, sikur len përshtypjen se fjala është për **vetëpërmbajtje gjyqësore**. Ky, në fakt, nuk është rasti sepse këtu sërish bëhet fjalë për **aktivizëm gjyqësor**, i cili, për më tepër, ka natyrë **ultra vires** dhe mbështetet në një arsyetim arbitrar. Standardi i autorizimit të dy organeve kushtetuese si më sipër për t'iu drejtuar **Gjykatës Kushtetuese** me kërkesë jashtë juridiksionit nga neni 113. parag. 2 & 3 të Kushtetutës është **ultra vires**, njëjtë si në rastin kur është vendosur me vendim meritor, **aktgjykim**, kurse arbitrar sepse anulimi është bërë me vendim jo-meritor, **aktvendim**, me një arsyetim tërësisht pavend dhe arbitrar. Këtë e kemi sqaruar më herët në këtë kapitull.[150]

Një situatë tjetër e **vetëpërmbajtjes gjyqësore**, por që lidhet me **ankesën kushtetuese**, ka të bëjë me rastet kur është e vështirë, nëse jo e pamundur, për të ushtruar vetëpërmbajtje për shkaqe procedurale për arsye se meritat e rastit janë të dukshme dhe imponuese. Në një situatë të tillë, çdo vetëpërmbajtje do të përbënte mohim të drejtësisë (**deni de justice**) dhe, për pasojë, rrënim të konceptit mbi gjyqësinë kushtetuese si mbrojtësin efektiv i lirive dhe të drejtave kushtetuese. Këtu, në mesin e rasteve shumë të rralla, vlen të përmenden rastet si vijon: rasti **Pasaportat,**[151] rasti **Fadil Hoxha dhe të tjerët**,[152] dhe rasti i **Kryeprokurori i Shtetit.**[153]

Në rastin **Pasaportat**, si objekt i kërkesës së palëve ka qenë cenimi i të drejtës për liri të lëvizjes nga neni 35.2 [Liria e Lëvizjes] i Kushtetutës. Njëjtë si në rastin në vijim, procedura ku është cenuar e drejta në fjalë ka qenë procedurë administrative në të cilën nuk është ofruar asnjë mjet efektiv juridik sepse natyra e shkeljes ka qenë specifike dhe ka rezultuar nga **Memorandumi Mirëkuptimit** (MM), i lidhur ndërmjet **Ministrisë së Punëve të Brendshme** (MPB), **Ministrisë së Drejtësisë** (MD) dhe **Këshillit Gjyqësor të Kosovës** (KGJK). Me MM, secilit person që gjendej në regjistra gjyqësorë, pa marrë parasysh rastin dhe natyrën e veprës apo stadin procedural të rastit penal kundër saj/tij, nuk i jepej certifikata për rregullimin e dokumentacionit për nxjerrjen e dokumentit të udhëtimit jashtë vendit - pasaporta. Ky kufizim i lirisë së lëvizjes, me fjalë të tjera, bëhej pa një vendim gjyqësor të një gjykate kompetente kosovare dhe për këtë nuk ekzistonte asnjë mjet juridik efektiv. Ky qëndrim i për moslëshim të pasaportave pa vendim të gjykatës kompetente u vlerësua nga vet MPB, si organ kompetent për lëshimin e dokumenteve të udhëtimit.[154]

Në rastin **Fadil Hoxha dhe të tjerët**, objekt i procedurës ka qenë vlerësimi kushtetutshmërisë së Vendimit Nr. 01/011-3257 të 30 prillit 2009 të **Komunës së Prizrenit**. Ky vendim kishte cenuar të drejtat kushtetuese të parashtruesve që kishin të bënin me ambientin jetësor, të drejtat zgjedhore dhe të drejtat e pjesëmarrjes në vetëqeverisjen lokale.[155] Esenca e vendimit ishte kjo: në vitin 1983, **Plani Urbanistik i Prizrenit** parashikonte hapësirë për gjelbërim në tokën e parkut të qytetit, e cila hapësirë tani përmes vendimit të sipërcekur objekt kontesti kthehej në zonë për ndërtim të lartë të banesave për familje të dëshmorëve dhe për nevoja sociale.[156] Sikundër shihet, konceptualisht ky rast nuk dallon nga rasti mësipërm.

Kërkesa e palëve, e shprehur në ankesën kushtetuese kishte për objekt anulimin e vendimit në fjalë të Komunës së Prizrenit me të cilin cenoheshin të drejtat kushtetuese si më sipër, kurse objekt i kërkesës

---

150 Cf. fusnotat nr. 10 &121 – 125, **supra,** si dhe teksti që i shoqëron komentet rreth tyre deri në fund të seksionit ku janë ato.

151 *Rasti KI 06/10. Aktgjykim. Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, 30 tetor 2010 Nr. Ref.: AGJ 63/10.

152 *Rasti KI 56/09. Aktgjykim. Parashtruesit: Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, 22 dhjetor 2010. Nr. Ref.: RK 77/10.

153 *Rastet KI 99/14 & KI 100/14. Aktgjykim. Parashtrues: Shyqyri Syla dhe Laura Pula. Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me procedurën e zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtine, 8 korrik 2014 Nr. ref.: AGJ679/14.

154 Rasti **KI 06/10**, para. 19-20.

155 Rasti **KI 56/09**, para. 27-29.

156 Rasti **KI 56/09,** para. 6, 9-10.

për masën e përkohshme, të cilën **Gjykata Kushtetuese** e kishte vënë dhe vazhduar disa herë deri në vendosjen meritore të rastit kishte të bënte me dëmin e pariparueshëm, i cili objektivisht shkaktohej nga ndryshimi i planit urbanistik të Komunës, i kryer me vendimin e **Komunës së Prizrenit**, përkatësisht nga ndërtimi i objekteve të larta në pjesën që dikur ishte planifikuar për gjelbërim dhe për të cilën ankoheshin **Fadil Hoxha dhe të tjerët**.

Problemi që paraqitej në fillim kishte të bënte me lejueshmërinë e ankesës kushtetuese në këtë rast dhe atë për dy arsye: e para, sepse vendimi kushtetutshmëria e të cilit sfidohej në Gjykatë nuk ishte një vendim individual por një vendim kolektiv i Komunës së Prizrenit për ndryshim të Planit Urbanistik, nga i cili proces ishin përjashtuar parashtruesit e kërkesës në fjalë;[157] e dyta, asnjë ligj kosovar nuk ofronte mjete juridike as efektive e as të një natyrë tjetër për adresimin e padrejtësive kushtetuese në të cilat ankoheshin parashtruesit. Kjo e bënte rastin specifik dhe rrethanat si më sipër lejonin Gjykatën të hynte në meritat e rastit, duke u bazuar në praktikën e **Gjykatës së Strasburgut**, e cila lejon që një rast të shqyrtohet në merita atëherë kur nga rrethanat e rastit del se pala nuk ka asnjë mundësi për të shfrytëzuar mjetet nacionale juridike, sepse ato nuk ekzistojnë ose vetë rrethanat e palës dhe të rastit nuk ofrojnë mundësi për shfrytëzimin e një mjeti efektiv juridik.[158]

Pas kalimit të pragut të lejueshmërisë, Gjykata vendosi meritat e rastit duke e anuluar vendimin e datës 30 prill 2009 të **Kuvendit Komunal të Prizrenit** me të cilin ndryshohej në mënyrë arbitrare **Plani Urbanistik**, duke përjashtuar qytetarët nga procesi i vendimmarrjes së tillë, gjë që përbën shkelje të të drejtave kushtetuese nga neni 52..2 [Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor] të Kushtetutës.[159] Këto të drejta, sipas interpretimit të Gjykatës, në jurisprudencën e **Gjykatës së Strasburgut** ndërlidhen respektivisht me nenin 2 [E Drejta për Jetën] dhe nenin 8 [E Drejta për Respektimin e Jetës Private dhe Familjare] të **KEDNJ**. Deri te ky konstatim Gjykata ka ardhur përmes analizës së **burimeve të buta** (**soft law**), duke filluar nga ato të nxjerra në kuadër të **OKB**-së e deri të **AP** e **KE**.[160]

I fundit nga rastet që kanë të bëjnë me procedurat administrative në të cilat kanë lindur shkeljet e të drejtave kushtetuese është rasti **Kryeprokurorit të Shtetit**. Në këtë rast, Gjykata anuloi vendimin për zgjedhjen e **Kryeprokurorit të Shtetit**, ani se nuk kishte ndodhur shterja e mjeteve juridike, njëjtë si në dy rastet e sipërcekura. Mosshterja ishte toleruar për shkak se bëhej fjalë për një institucion të rëndësishëm dhe të vetëm shtetëror ashtu që nuk mund të pritej shterja e mjeteve për të konstatuar nëse procedurat e zgjedhjes së **Kryeprokurorit të Shtetit** kishin qenë të vlefshme në aspektin kushtetues dhe ligjor. Një pritje e tillë do të zgjaste me vite ashtu që ajo pozitë do të ngelej vakant dhe me ushtrues detyre. Ky argument ka qenë i pathënë në tekst, mirëpo gjendet në themel të vendimit për anulimin e **Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës** (KPK) nr. 151/2014 të Këshillit Prokurorial të Kosovës, të 6 qershorit 2014 të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) për zgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit.[161] Krahas këtij argumenti, vend të veçantë në arsyetimin e Gjykatës, krejtësisht në mënyrë shprehimore, gjejnë edhe argumentet që janë përdorur për dy rastet si më sipër, përkatësisht argumentet që në këtë procedurë administrative rendi juridik kosovar nuk ofron **mjete juridike efektive**[162] dhe se specifikat e secilit rast duhet të merren për bazë me rastin e vendosjes lidhur me plotësimin e kriterit të shterjes së mjeteve

[157] Rasti **KI 56/09**, para. 66.

[158] Rasti **KI 56/09**, para. 38-59.

[159] Rasti **KI 56/09**, pika II.

[160] Rasti **KI 56/09**, para. 62-65.

[161] "[…] 53. Së dyti, Gjykata vëren se ekziston vetëm një pozite për Kryeprokuror të Shtetit, si, për shembull, në krahasim me pozitat e shumta për emërimin dhe për riemërimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Kështu, Gjykata është e vetëdijshme se ka pranuar disa aplikacione prej gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët nuk janë riemëruar. Rasti i tanishëm, megjithatë, është faktikisht ndryshe. Së pari, për shkak se në ato raste të tjera ka pasur pozita të shumta dhe gjykatat e rregullta mund të kenë korrigjuar aplikacionet, në qoftë se shkelja është dëshmuar muaj më vonë. Së dyti, në rastin konkret, nuk duket se ka kohë të mjaftueshme për ndonjë gjykatë tjetër ta adresojë këtë mjet juridik para emërimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës." Rasti **KI 56/09**.

[162] "[…] 48. Gjykata vëren se dispozitat e ligjit në fuqi, Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nuk parashikojnë asnjë mjet juridik kundër vendimeve të kontestuara nga parashtruesit e kërkesës ". **Rastet KI 99/14 & KI 100/14**. Cf. po ashtu edhe parag. 50 & 54 të rastit **KI 56/09.**

juridike. Ky i fundit, në fakt, përbën një standard të rregullt të **Gjykatës së Strasburgut**, krahas atij që ka të bëjë me rrethanat specifike të secilit rast konkret. Në rastin që diskutojmë, specifika më e madhe ishte se është bërë fjalë për një organ të vetëm ashtu që nuk mund të durohej zvarritja e procedurave standarde të kontestimit gjyqësor të ligjshmërisë së vendimit administrativ mbi zgjedhjen e kryeakuzatorit kosovar. Ky ishte një test objektiv, të cilin e gjejmë në shumë vende të Ballkanit dhe më gjerë, ku për kushtetutshmërinë e zgjedhjes së organeve qendrore të shtetit, përfshirë kryeprokurorin, vendosin në shkallë të parë dhe të fundit gjykatat kushtetuese.[163] Këtë rrethanë duhet ta ketë pasur parasysh **Raporti i Progresit për Kosovën** për vitin 2014,[164] kur ka thënë se në të ardhmen duhet të krijohen procedura efektive të shterjes së mjeteve juridike për realizimin e të drejtave kushtetuese të atyre që konkurrojnë në këtë post të rëndësishëm shtetëror, duke ia lënë **Gjykatës Kushtetuese** një hapësirë vlerësimi që është më dinjitoze, jo të ndodh siç ka ndodhur që ajo të vlerësoj procedurat administrative të një niveli tejet të ultë dhe joprofesional, siç janë procedurat administrative të **KPK**.

Vite më vonë, pas mbarimit të mandatit të kryetarit të parë të **Gjykatës Kushtetuese**, autorit të parë të këtij libri, janë nxjerrë disa vendime të ngjashme dhe në tërësi të argumentuara me burim të njëjtë si në rastin e sipërm të **Kryeprokurorit të Shtetit**. E kemi fjalën për vendimet e **Gjykatës Kushtetuese** në rastin e zgjedhjes së kryetarit të **Gjykatës Supreme**[165] dhe kryetarit të **Gjykatës së Apelit.**[166]

14.6. Kultura juridiko-politike në Kosovë si shkak i keqkuptimeve lidhur me rëndësinë dhe rolin e aktivizmit gjyqësor në kohë tranzicioni

Në literaturë është vërejtur me shumë të drejtë se gjyqësia kushtetuese post-komuniste ka lindur dhe është zhvilluar nën hijen e kulturës kushtetuese komuniste.[167] Me kulturë kushtetuese nuk nënkuptohet mënyra e jetesës, siç ndodhë në të folurit e përditshëm, por një koncept shumë i strukturuar dhe me përmbajte të ndryshme.

Në rend të parë, kultura kushtetuese ngërthen produktet dhe refleksionet mentale, të individëve dhe të shoqërisë marrë si tërësi, lidhur me objektet e caktuara politike. Në këtë strukturë kuptimore, sikundër shihet, kërkohet definimi dhe sqarimi i kuptimit të termit "produkte dhe refleksione mentale" dhe i termit

---

163 Për më tepër, Gjykata kishte aplikuar edhe një test subjektiv që lidhet me personin e Kryeprokurorit të Shtetit, në **paragrafin 75** të Aktgjykimit në rastet **KI 99/14 & KI 100/14.** Në këtë paragraf, të cilin për shkak të rëndësisë që ka, si dhe për faktin se koha dëshmojë që posti që u muar më pastaj nga **Aleksandër Lumezi**, në cenim të tërësishëm të nenit 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Kosovës, në tërësi shpërputhej me cilësitë personale të cilat i kërkonte **Gjykata Kushtetuese** në paragrafin e sipërcekur, ku u tha si vijion:
"[...] 75. Në këtë drejtim dhe në mënyrë të veçantë duke iu referuar rëndësisë dhe natyrës së pozitës së Kryeprokurorit të Shtetit, Gjykata vëren se edhe shfaqjet e paanshmërisë mund të jenë të një rëndësie te veçantë (Shih, *mutatis mutandis,* rasti *De Cubber kundër Belgjikës,* Kërkesa nr. 9186/80, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 tetorit 1984, par. 26). Çështje e rëndësishme këtu është besimi, të cilin një autoritet publik, në një shoqëri demokratike, siç është KPK-ja, gjatë procesit të zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit, duhet ta bartë në publik, si dhe besimi i publikut në personin e zgjedhur si Kryeprokuror te Shtetit."

164 "[...] In July, the Constitutional Court ruled that the selection process of a new chief state prosecutor, finalised in June, had to be repeated. An acting chief state prosecutor has been appointed for the following the retirement of the previous chief state prosecutor in August. Proper legal remedies against decisions of the prosecutorial and judicial councils should be introduced to avoid that the only resort against their decisions is the Constitutional Court." European Commission, *Kosovo Progress Report 2014* (Brussels, 8.10.2014 SWD(2014) 306 final) fq. 12. Në internet:https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo -progress-report_en.pdf.

165 *Rasti KI 34/17. Aktgjykim. Parashtrues: Valdete Daka. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK nr. 50/2017, të 6 marsit 2017*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 12 qershor 2017. Nr. ref.: AGJ 1092/17.

166 *Rasti KI 55/17. Aktgjykim. Parashtrues: Tonka Berisha. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit KGJ nr. 13/2017, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të 13janarit 2017*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, 17 korrik 2017. Nr. rcf.: AGJ 1106/17.

167 Ruti Teitel, "Post-Communist Constitutionalism: A Transitional Perspective", fq. 167-190 (ku autori flet për lindjen e gjyqësisë kushtetuese komuniste dhe rolin e pashmangshëm aktiv të gjykatave kushtetuese post-komuniste si pasojë e misionit të tyre transformues të kulturës së mëhershme komuniste; sipas këtij shkrimi, me plot të drejtë del se nuk ka qenë bërja e kushtetutave të reja qasje dominuese e vendeve ish-komuniste, por themelimi i gjykatave të reja kushtetuese si mekanizma dhe instrumente të reja të transformimit të shoqërive post-komuniste në shoqëri liberale dhe të bazuara në sundimin e ligjit).

"objekte politike". Kjo definohet dhe sqarohet vetvetiu pasi të merret vesh se kush bën pjesë në njërin kuptim e kush në tjetrin. Në **produkte** e **refleksione mentale** hyjnë orientimet (**bindjet**, **vlerat** dhe **qëndrime**t) e popullsisë ndaj **objekteve politike**. Në orientime hyjnë bindjet, vlerat dhe qëndrimet e njerëzve ndaj objekteve politike, kurse me objekte politike nënkuptohen objektet që veprojnë si stimulues (nxitës) për gjenerimin e orientimeve politike të njerëzve . Në **objekte politike** bëjnë pjesë këto kategori:

- një, sistemi politik si tërësi (historia e tij, vendndodhja, pushteti në te, kushtetuta dhe cilësitë dalluese të shtetit);
- dy, organizatat dhe institucionet që kanalizojnë kërkesat dhe mbështetjet ndaj sistemit dhe që konvertojnë këto kërkesa dhe mbështetje ndaj sistemit në politika shtetërore/publike (partitë politike, grupet e interesit, mediet, legjislaturat dhe rolet e strukturat tjera);
- tre, aparati administrativ burokratik, gjykatat dhe institucionet tjera që janë në ngarkesë të zbatimit dhe ligjit dhe vënies në jetë të vendimeve shtetërore; dhe
- katër, roli dhe pozita e individit në shoqëri dhe mënyra e realizimit të vetvetes në shoqëri

Mendimet e refleksionet e individëve dhe të shoqërisë marrë si tërësi lidhur me vendin dhe pozitën në një shtet të partive politike, kushtetutës, shtetit, historinë e formimit dhe zhvillimit të shtetit, organizatat dhe institucionet që kanalizojnë dhe mbështesin kërkesat dhe i konvertojnë ato në politika shtetërore/publike, aparatit administrativ-burokratik të shtetit dhe kështu me radhë paraqesin strukturën dhe vetë esencën e kulturës konkrete kushtetuese. E thënë me fjalë të tjera, orientimet e njerëzve ndaj objekteve politike të definuara dhe përshkruara në katër kategori si më sipër paraqesin strukturën dhe përmbajtjen e kulturës politike dhe kushtetuese në një vend. Kjo kulturë ndryshon prej vendi në vend dhe në periudha të ndryshme historike të zhvillimit të një vendi. Ndryshimi i orientimit të njerëzve dhe individëve ndaj objekteve politike, jo vetëm ndaj sistemit politik por edhe ndaj përbërësve tjerë të përshkruar si më sipër (organet shtetërore, organizatat, liritë dhe të drejtat e njeriut, roli i administratës dhe i burokracisë në shoqëri etj.), përbën ndryshim të identitetit politik dhe kushtetues të një shoqërie.

E parë në këtë prizëm, përkatësisht në prizmin e kulturës kushtetuese konkrete, kushtetuta nuk paraqet më një dokument të shkruar, por një diçka që ngjanë me kuptimin e saj aristotelian e që është një tërësi apo si një sistem i jetesës së njerëzve në një shoqëri të organizuar në shtet. Kjo do të thotë se kushtetuta shërben si një sistem vlerash dhe qëndrimesh që orientojnë shoqërinë ndaj **objekteve politike** ekzistuese në një kohë dhe në një hapësirë të dhënë. Ky sistem vlerash dhe qëndrimesh konkrete ndaj objekteve politike të përcaktuara me kushtetutë, në të njëjtën kohë, ngërthen në vetvete predispozita për veprim politik konkret. Si të tilla, këto predispozita marrin domethënie konkrete nga ndikimi faktorëve tjerë rrethanor (ambiental), siç janë: **tradita**, **kujtesa historike**, **normat**, **emocionet** dhe **simbolet**.[168] Të marra së bashku me katër kategoritë përbërëse si më sipër, këto përbëjnë kulturën juridiko-kushtetuese të një shoqërie konkrete. Në këtë kuptim, **Kosova** e sotme ka një dallim thelbësor me Kosovën e kohës së komunizmit dhe kulturën e saj politike dhe kushtetuese.

Në kohën e komunizmit, kultura kushtetuese, përkatësisht orientimi i individëve dhe i shoqërisë si tërësi ndaj individit dhe shtetit kanë qenë të brumosur me ide dhe mendime sipas të cilave kushtetuta nuk ka karakter normativ, përkatësisht se ajo ka një karakter programatik-propagandistik ashtu që asnjëherë, si e tillë, nuk mund të vihej në jetë përmes mekanizmave gjyqësor dhe tjetër. Në këtë kulturë kushtetuese, kushtetuta nuk paraqiste asgjë më shumë se një dokument partiak që shprehte dhe shpërfaqte synimet dhe qëllimet e zhvillimit të përgjithshëm të një shoqërie: përcaktimi kushtetues lidhur me origjinën, formën dhe organizimin e pushtetit në shoqëritë komuniste kanë pasur për qëllim që t'ia bënin me dije qytetarit se ekziston një sistem i tillë politik dhe asgjë më shumë. Asnjë garancion kushtetues lidhur me formën dhe organizimin e pushtetit, lëre më lidhur me liritë dhe të drejtat kushtetuese, nuk ka pasur

[168] Levent Gönenç, *Prospects for Constitutionalism in Post-Communist Countries* (Martinus Nijhoff Publishers: The Hague, 2002) fq. 27-102;

efekt dhe kuptim normativ. Çdo garancion kushtetues, i futur në dispozitat e ndryshme kushtetuese, nuk ka qenë më shumë se një dekor formal propagandistik i ideologjisë zyrtare komuniste. Kjo kulturë kushtetuese dhe këto botëkuptime lidhur me sistemin politik dhe përbërësit e saj janë mësuar si të tilla nëpër librat e drejtësisë dhe janë marrë si të mirëqena. Mjafton të shikohet librat mbi të drejtën kushtetuese të autorëve të kohës së komunizmit dhe dëshmohet rërë kjo që u tha më sipër.

Gjendja ka qenë edhe më dramatike sa i përket përbërësit të katërt të objekteve politike – individit. Sa i përket **individit**, rolit dhe pozitës së tij në shoqëri, **kultura kushtetuese komuniste** e ka konceptuar dhe parë atë si një subjekt tërësisht pasiv, që duhet t'i nënshtrohet idealeve dhe synimeve madhore të ndërtimit të socializmit dhe shoqërisë pa klasa që synohej - komunizmit. I njëjtë ka qenë edhe mendimi individual dhe shoqëror lidhur me **partitë politike** dhe me përbërësit tjerë të kategorisë së dytë: këta përbërës të objekteve politike dhe tolerimi e kultivimi i tyre janë parë si një rrezik ekzistencial për sistemin kushtetues komunist, përkatësisht si diçka që nuk mund të ekzistojë dhe nuk duhet të tolerohet në kushtet e monopolit politik dhe ideologjik të partisë komuniste si avangardë e shoqërisë dhe e të gjitha shtesave të saj. Shteti partiak ka qenë forma dominante e organizimit politik, pa asnjë pluralizëm politik apo pluralizëm të mendimeve tjera jo-zyrtare.

Në vijim si më sipër, as **gjyqësia kushtetuese** dhe përbërësit e kategorisë së tretë të objekteve politike nuk kanë pasur një tretman më të ndryshëm se përbërësit e kategorive të sipërcekura. Po ashtu rreth tyre në diskursin publik ish-komunist ka ekzistuar një orientim (bindje, qëndrim apo sistem i caktuar i vlerave): gjykatat, së bashku me përbërësit e kësaj kategorie, janë parë si një mekanizëm arsyetues i parimit të unitetit të pushtetit komunist me rastin e interpretimit të ligjit (kushtetuta fare nuk ka pasur nevojë të interpretohet për qëllim të vënies në jetë sepse nuk është kuptuar si dokument me forcë normative), me kuvendin si organin më të lartë të pushtetit shtetëror dhe me individin në një pozitë inferiore kundrejt shtetit dhe aparatit të tij të dhunës, pa asnjë mundësi për realizimin gjyqësor të të drejtave dhe lirive të garantuara kushtetuese. Në fakt, korpusi i lirive dhe i të drejtave kushtetuese në sistemet komuniste ka qenë një dekor i thjeshtë, përmbajtja e të cilave në tërësinë e tyre ka mund të caktohet dhe të abrogohet me ligje të zakonshme, gjë që ka qenë edhe përcaktim kushtetues shprehimor. Në këtë kuptim, kushtetutat komuniste zakonisht kanë garantuar të drejtat dhe liritë e caktuara kushtetuese, pa mundësi të vënies së tyre në jetë në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes mekanizmit të gjyqësisë kushtetuese. Në të njëjtat dispozita kushtetuese garantuese kanë ekzistuar klauzolat që kanë lejuar mundësinë e ligjvënësit për të përcaktuar përmbajtjen e lirisë apo të drejtës konkrete kushtetuese, deri në prishjen e tërësishme të vetë esencës së të drejtës apo lirisë kushtetuese të njohur formalisht.

Çdo gjë që u tha për **objektet politike** si më sipër vlen, **mutatis mutandis**, edhe për shtetin dhe kuptimin e tij: institucioni i shtetit në atë kohë kuptohej si një instrument i dhunës fizike në duart e klasës punëtore që ka për qëllim mbrojtjen e mënyrës komuniste të prodhimit dhe të marrëdhënieve shoqërore që bazohen në këtë mënyrë prodhimi. Aspektet tjera të ndërtimit të shtetit janë ndrydhur: asnjë faktor tjetër pos faktorit klasor nuk është marrë seriozisht në konsideratë si instrument shpjegues i rrugës imagjinare të ndërtimit të shtetit komunist . Edhe aspekti nacional iu ka nënshtruar një versioni të caktuar të vetëvendosjes - vetëvendosjes komuniste. Kjo vetëvendosje brumosej, orientohej dhe dirigjohej nga partia komuniste si avangardë e saj me qëllim përfundimtar ndërtimin e një shoqërie pa klasa të quajtur komunizëm. Edhe interpretimi i kushtetutës, në fakt, nuk ka qenë interpretim por vetëm ndjekje e linjës partiake. Kjo shpjegon faktin se pse në komunizëm amendamentimet kushtetuese çdoherë janë konsideruar si diçka që synon ndjekjen dhe përshtatjen ndaj rrethanave të ndryshuara, vlerësim që çdoherë i ka takuar partisë komuniste si avangardë e asnjëherë ndonjë organi tjetër gjyqësor. Në të vërtetë, sikur të kishin pasur gjykatat, përfshirë gjykatën kushtetuese, prerogativën e interpretimit të kushtetutës me qëllim të përshtatjes së saj rrethanave të reja, atëherë nuk do të kishte ardhur asnjëherë deri të nevoja e arsyetimit të amendamentimeve kushtetuese me terma të tilla si më sipër.

Kjo deri këtu i takon trajtimit makro të kulturës kushtetuese dhe përbërësve të saj, strukturës dhe dinamikave që zhvillohen kur ndërveprojnë përbërësit e një kohe dhe hapësire të caktuar. Ekzistojnë edhe **nivele lokale** të kulturës së përgjithshme juridike dhe politike, të cilat ne më së shumti na interesojnë në këtë seksion.

Në hulumtimet e bëra në vendet post-komuniste është vërejtur se krahas dizajnit institucional në kuadër të të cilit kryhet gjykimi kushtetues (juridiksioni dhe fizionomia e mekanizmit kushtetues për zgjidhjen e rasteve dhe mosmarrëveshjeve kushtetuese), përkatësisht krahas tekstit kushtetues që interpretohet dhe ambientit politik në të cilin ndodhë ky interpretim, **kultura e përgjithshme juridike në nivel lokal**, e rrënjosur për dekada dhe shekuj në zhvillimet juridike nacionale, përbën një faktor të rëndësishëm që ndikon në intensitetin dhe cilësinë e aktivizmit gjyqësor.[169] Kjo **kulturë juridike**, e kuptuar kësisoj, pra si një marrëdhënie dhe orientim i caktuar i **produkteve mentale** (**bindjeve**, **vlerave** dhe **qëndrimeve)** ndaj **objekteve të caktuara politike**, të përshkruara si më lartë në katër kategoritë përbërëse, përbën në thelb **ADN**-në e gjykatave kushtetuese në një vend dhe kohë të caktuar.

Nuk do mend se, në anën tjetër, vetë kultura juridike në përgjithësi paraqet pjesë të pandarë të **kulturës politike,** përkatësisht pjesë të prirjeve të dhëna për veprim politik të natyrës dhe drejtimit të caktuar. Në përbërësit e kësaj kulture hyjnë, jo vetëm tradita juridike, e cila domosdo është e rëndësishme, por edhe faktorë të tjerë institucional dhe sistemik të momentit. Këta përbërës të fundit, vijnë në shprehje në veçanti në **shoqëritë në tranzicion**, ku hyjnë edhe vendet ish-komuniste. Në këto vende orientimi individual dhe kolektiv kundrejt objekteve politike është përcaktuar në një masë shumë të madhe nga kultura e kaluar juridike: institucionet dhe faktorët e momentit që u krijuan si rezultat i ndryshimeve **radikale në regjimet politike dhe kushtetuese pas rrënimit të komunizmit** kanë përbërë një faktor me ndikim shumë të madh pikërisht si rezultat i kulturës së trashëguar juridike, e cila u bart në këto institucione dhe në këta faktorë të momentit të krijuar rishtas.

Në mesin e institucioneve dhe faktorëve të tillë momental, por me shumë rëndësi, bën pjesë kushtetutëbërja, përkatësisht procesi i krijimit të një kushtetuese, i cili, si proces, paraqitet në formë të pasojës, pra jo si shkak i ndryshimit të orientimit ndaj objekteve politike ekzistuese. E thënë me fjalë të tjera, në këto shoqëri ka ardhur deri te ndryshimi strukturor i shoqërisë së organizuar në shtet, që erdhi pas rënies së komunizmit, jo si rrjedhojë e ndryshimit të botëkuptimeve orientuese rreth objekteve politike ekzistuese të kohës. Kjo është arsyeja që kushtetutëbërja dhe ndërtimi institucional në **vendet ish-komuniste** ka qenë i natyrës skajshmërisht **elitike**, që nënkupton se legjitimimi i tyre është bërë **post-festum**, kryesisht përmes rolit që kanë luajtur gjykatat kushtetuese si akterë frenues dhe kontrollues të pushtetit të ri dhe, në të njëjtën kohë, si mbrojtës të lirive dhe të drejtave të individit në kushtet e reja të ndryshimeve të thella strukturore në shoqëritë e tilla.[170] Kjo gjendje, në vija të përgjithshme dhe shikuar në aspektin filozofik dhe konceptual, nuk ndryshon dukshëm as në rastin e **Kosovës**. Në terma praktik, megjithatë, gjëra ndryshojnë për shkak të historisë tragjike të vendit pas rënies së komunizmit. Por, përsërisim, në aspektin konceptual shpjegimi është i njëjtë edhe në rastin kosovar. Kjo është kështu sepse në themel të këtij ndryshimi praktik sërish qëndron kultura juridike kosovare e cila është trashëguar nga e kaluara, ani se me një ndërprerje të gjatë pas rënies së komunizmit. Të shohim si duket kjo nga afër.

Janë dy specifika që e bëjnë të dallueshëm rastin e gjyqësisë kushtetuese në **Kosovën** e pas vitit 2009 me vendet tjera ish komuniste: *e para*, ajo ka lindur dhe është zhvilluar nën hijen e vlerave të sistemit ish-komunist jugosllav; dhe, *e dyta*, lindja e saj ka ndodhur pas një ndërprerjeje relativisht të gjatë prej

[169] Radoslav Prochzka, *Mission Accomplished: On Founding Constitutional Adjudication in Central Europe*, fq. 9-10.

[170] Në fakt, fundi i komunizmit i ka vënë vendet ish-komuniste evropiane në luftë dhe betejë afatgjate për drejtësi kushtetuese, e kjo nënkupton luftë dhe betejë për sigurimin e supremacisë (epërsisë) së kushtetutave të reja nacionale përmes rrugëve gjyqësore. Kjo ka qenë kështu për shkak se tani kushtetutat e reja të këtyre vendeve, pa përjashtim, ngërthenin norma mbi ndarjen dhe balancimin e pushteteve, sundimin e ligjit, demokracinë dhe, mbi të gjitha, respektin dhe promovimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve të garantuara me kushtetutë. Cf., për këtë më shumë në studimin elokuent të Herman Schwartz, *The Struggle for Constitutional Justice for in Post-Communist Europe*.

gati dy dekadave dhe dhunës serbe të dirigjuar nga diktatori serb **Sllobodan Millosheviq**, periudhë që është pasuar nga administrimi absolut dhe autoritar i administratës së **UNMIK**-ut . Krahas këtyre dy faktorëve objektiv ekziston një faktor *i tretë*, i cili po ashtu flet mjaft për aktivizmin gjyqësor të Gjykatës Kushtetuese pas themelimit të saj në vitin 2009. E kemi fjalën për juridiksionin mjaft të gjerë të Gjykatës. Ky juridiksion është i ngjashëm me juridiksionin që e gëzojnë gjykatat e vendeve **ish-komuniste** në **Evropë** dhe përtej. U muar vesh, këtu e kemi fjalën për gjykatat kushtetuese të dizajnuara sipas **modelit evropian/keslenian**.

Faktorët ndikues në aktivizmin gjyqësor si më sipër, sikundër shihet, kanë natyrë objektive përveç njërit, përkatësisht përveç faktorit që ka të bëjë me fizionominë e Gjykatës Kushtetuese të përcaktuar me Kushtetutë. Ky faktor apo kjo rrethanë, megjithatë, nuk ka qenë shtytësi kryesor dhe i vetëm që ka ndikuar apo që shpjegon atë pak aktivizëm që e ka kultivuar Gjykata në vitet e para formative.

Në **Kosovë**, njëjtë si gjetiu nëpër botë, kultura paraqet si një ndër faktorët objektiv me rëndësi që ndikon në perceptimin në sytë e publikut të gjykatave kushtetuese si gjykata aktiviste. Kjo ekziston dhe vërehet edhe në rastin e vendeve të tjera në katër anët e botës. Për këtë arsye në fillim diskutojmë praktikën e huaj gjyqësore, para së të kalojmë në shtjellimin tonë të rasteve që më shumti janë përfolur si vendime aktiviste të **GJKRKS**. Këtë qasje e përzgjedhim sepse ekziston nevoja e krahasimit të situatës sonë me atë të gjykatave të huaja kushtetuese, për të arritur deri të konstatimi lidhur me atë nëse **Gjykata Kushtetuese** ka qenë me të vërtetë aktiviste. Me këtë rast shpërfaqen dy situata: e para i referohet situatave kur segmente të caktuara të publikut, të a.q. **ekspert kushtetues**, vetë në një mënyrë arbitrare i kanë cilësuar si aktiviste disa vendime, pa asnjë shtjellim të përmbajtjes së tyre; dhe, situata e dytë që lidhet me rastet kur objektivisht vendimet kanë qenë aktiviste sipas çdo kriteri matës dhe ky fakt ka qenë i prodhuar me vetëdije. Prezenca e situatës së fundit dëshmohet me faktin se vetë Gjykata më vonë ka bërë përpjekjet për të ndryshuar precedentin e mëparshëm, ndryshim që në aspektin profesional i përket mënyrës tërësisht të gabuar.

T'i kthehemi tani praktikës së huaj gjyqësore. Modeli i ndjekur i teknikave të interpretimit në praktikat gjyqësore, me fokus të veçantë në aktivizmin gjyqësor, sipas hulumtimeve empirike të kryera nëpër disa vende perëndimore, ka qenë i ndikuar dhe i diktuar nga po ata faktorë objektiv që shpërfaqen edhe në rastin e Kosovës, me përjashtim të specifikave që kanë të bëjnë me historinë tragjike të Kosovës gjatë kohës së diktatorit serb **Sllobodan Millosheviq**. Në këta faktorë objektiv, kultura juridike dhe sistemi kushtetues nacional zënë vend të veçantë. Për të dëshmuar këtë konstatim, në vijim japim rezultatet empirike të disa vendeve, të cilat i kemi përzgjedhur me randomizim (kuturu) për shqyrtim, sipas rendit alfabetik:

- **Afrika e Jugut**
- **Australia**
- **Austria**
- **Brazili**
- **Çekia**
- **Gjermania**
- **Franca**
- **Hungaria**
- **Italia**
- **Kanada**
- **Mbretëria e Bashkuar** dhe
- **Spanja.**

Diskutimi në vijim nuk shtjellon rastet konkrete të aktivizmit gjyqësor sepse një gjë e tillë do të tejkalonte dukshëm caqet e këtij kapitulli dhe librit marrë si tërësi. Ajo që shtjellohet ka të bëjë me paraqitjen e kulturës juridike dhe sistemit kushtetues si dy faktorë objektiv, të cilët, në periudha të caktuara të zhvillimit, kanë shkaktuar aktivizëm gjyqësor. Përzgjedhja e vendeve është bërë sipas rendit alfabetik,

por me randomizim (kuturu). Jemi të bindur se, megjithatë, vendet në fjalë reflektojnë, ashtu siç janë, mesataren e kulturave juridike në vendet e demokracive kushtetuese perëndimore. Këtë e dëshmojnë rreshtat në vijim.

Në **Afrikën e Jugut** ekziston një sistem mikst i qeverisjes, një qeverisje parlamentare por me një shef shteti me autorizime ekzekutive por që i përgjigjet parlamentit. **Gjykata Kushtetuese e Afrikës** së Jugut (**GJKAJu**) shërben si gardian i Kushtetutës, në fuqi nga viti 1996, krahas gjykatave të rregullta, të cilat po ashtu ushtrojnë juridiksion kushtetues (njëjtë si në **SHBA**). Vendimet e kësaj të fundit janë të detyrueshme sipas standardit **stare decisis**, nisur nga fakti se në këtë vend sistemi i të **drejtës së përgjithshme** bashkëjeton me sistemin e të **drejtës civile**. Para nxjerrjes së **Kushtetutës Tranzitore** (1993), ka ekzistuar supremacia (epërsia) e parlamentit dhe e produktit të tij - ligjit. Kjo rrethanë nuk lejon që gjyqësori i rregullt të ketë ndonjë rol të madh në zëvendësimin e vullnetit të ligjvënësit. Kjo është na harmoni me sistemin britanik, që ka pasur ndikim të fuqishëm në sistemin kushtetues dhe juridik në këtë vend.

Pas rrënimit të sistemit të **Apartheit**-it, u instalua sistemi demokratik i qeverisjes. Në kuadrin e institucioneve kushtetuese, të panjohura për sistemin kushtetues britanik sipas të cilit modelohej vendi, ka qenë **GJKAJu**, e cila ka pasur një rol thelbësor në tranziconin demokratik në këtë vend. Ky rol shpërfaqet për faktin se Kushtetuta referon burime të tjera të tjera të së drejtës, të largëta dhe të panjohura për traditën lokale, që duhet të merren parasysh me rastin e vendosjes së rasteve. Një rrethanë si kjo llogaritet të ketë qenë një ndër arsyet që **GJKAJu** ka pasur shumë sukses: vetë teksti i dy kushtetutave (1993 dhe 1996) kanë referuar rë drejtën ndërkombëtare, parimet dhe vlerat e saj, si burim të së drejtës kushtetuese. Si burim i së drejtës kushtetuese në këtë vend mund të shërbej edhe e drejta e huaj. Jo vetëm kaq! **GJKAJu** shpesh herë është mbështetur në argumente ekstra-kushtetuese për të realizuar misionin e saj të ndërtimit të një shteti demokratik që nuk bazohet në diskriminim racor, **Apartheid**, një traditë kjo fatkeqe që ka shoqëruar të kaluarën e këtij vendi përgjatë tërë kohës së **Luftës së Ftohtë.**[171]

Në **Australi** ekziston një sistem juridik i të **drejtës së përgjithshme**, krahas ndikimit të fuqishëm të sistemit të së drejtës civile. Për herë të parë, ky vend ka nxjerrë kushtetutën e vet në vitin 1901, e cila kushtetutë ka pasur formën e ligjit të **Westminster**-it dhe ka shërbyer si bazë për rregullimin e formës dhe të organizimit të sistemit kushtetues. Sa i përket lirive dhe të drejtave të njeriut, ndërkaq, vlen të theksohet se mungon një kartë kushtetuese, gjë që nuk është rasti me ish-kolonitë tjera britanike, të cilat kaherë kanë nxjerrë kartat e tyre mbi liritë dhe të drejtat e njeriut.[172]

Kjo gjendje kësisoj, ku dominon e **drejta e përgjithshme** kundrejt të drejtës civile, domosdo që len hapësirë të madhe për aktivizëm të gjykatave, të cilat çdoherë i japin përparësi interpretimeve të lëna trashëgim nga e kaluara. Kjo në veçanti vlen për rëndësinë dhe rolin e **Gjykatës së Lartë të Australisë**, e cila me kushtetutë e ka të njohur të drejtën e ushtrimit të kontrollit gjyqësor mbi institucionet, proceset dhe rezultatet politike dhe administrative, duke formësuar në këtë mënyrë autorizimet kushtetuese të autoriteteve qeverisëse dhe të qeverisjes në vend. Në kohët e fundit ka pasur kritika ndaj aktivizmit gjyqësor të kësaj gjykate, i cili modelohet sipas sistemit amerikan, në të cilën ushtrohet juridiksion origjinal në çështjet kushtetuese në nivel nacional.[173]

---

171 Lynn Berat, "Courting Justice: A Call for Judicial Activism in a Transformed South Africa " *Saint Louis University law Journal* Vol. 37 No. 4 (Summer 1993) fq. 849-869; Christian Rautenbach and Lourens Du Plessis, "The Constitutional Court of South Africa". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* (Cambridge University Press: Cambridge, 2017) fq. 560-603, në fq. 561-565.

172 Cherly Saunders and Adrienne Stone, " The High Court of Australia". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* fq. 36-74 në fq. 36-38.

173 Brian Galligan, "Judicial Activism in Australia". Në Keneth M. Hollan (ed.), *Judicial Activism in Comparative Perspective* (Palgrave Macmillan: London, 1991) fq. 70-89; Horst Lucke, "Legal history in Australia: The development of Australian legal/historical scholarship". *Australian Bar Review* Vol. 34 No. 1 (2010) fq. 109-148.

Austria paraqet një rast unik në traditën evropiane të gjyqësisë kushtetuese dhe, për pasojë, edhe në traditën e aktivizmit gjyqësor të modelit **evropian/kesenian**. Në të vërtetë, në aspektin e gjyqësisë kushtetuese, ky vend paraqet prijësin e kësaj gjyqësie, nisur nga fakti se vetë ideja për te ka lindur nga **Hans Kelsen**, që u materializua me krijimin e **Gjykatës Kushtetuese të Austrisë** (**GJKAu**) më 25 janar 1919. Për këtë kemi folur gjerësisht gjetiu.[174]

Ky vend është specifik për disa arsye: e para, që në vitin 1964 e ka bërë **KEDNJ** pjesë të rendit të vet juridik; e dyta, në vitin 1995, me hyrjen në **BE**, ka pranuar supremacinë (epërsinë) e sistemit juridik evropian; dhe, së fundi, në viti 2012, **GJKAu** vendosi që **Kartën Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (Karta)** ta konsideroj si burim të së drejtës. Këto tri segmente çojnë peshë në të kuptuarit e aktivizmit gjyqësor në këtë vend, krahas të kuptuarit e juridiksionit standard të **GJKAu**, i cili ka të bëj me kontrollin abstrakt të normës dhe juridiksionin që lidhet me kontrollin kushtetues të vendimeve gjyqësore në lëmin administrativ.

Në fillim, në mes të dy luftërave botërore deri në vitet '60 të shekullit të kaluar, juridiksioni i **GJKAu** ka pasur të bëjë kryesisht me çështjet lidhur me formën dhe organizmin e pushtetit. Më vonë, ky juridiksion ka përfshirë, në mënyrë graduale, sferat tjera të marrëdhënieve shoqërore: pas mbarimit të **Luftës së Ftohtë** dhe, në veçanti, pas futjes së vendit në **BE**, gjyqësia kushtetuese austriake mori një rol më të spikatur. Aktualisht **GJKAu** ka një rekord të lartë të adresimit të pyetjeve preliminare në **Gjykatën Evropiane të Drejtësisë** (GJED) me qëllim të harmonizimit të rendit juridik austriak me atë të BE-së. Kjo vlen edhe për sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut sepse, siç u tha, nga viti 2012, **Karta** u bë pjesë përbërëse e rendit juridik-kushtetues austriak.

Të gjitha këto angazhime ndërkombëtare në nivel evropian, të koventuara në detyrime kushtetuese, domosdo që kanë pasur për pasojë rritjen e aktivizmit gjyqësor të **GJKAu**. Kjo në veçanti ka ardhur në shprehje në lëmin e lirive dhe të drejtave të njeriut, ku më nuk bëhet fjalë vetëm për mbrojtjen e parimit të ligjshmërisë, por edhe për mbrojtjen efektive të lirive dhe të drejtave të njeriut. Në këtë aspekt, interpretimi teleologjik mori peshë më të madhe kundrejt interpretimit tekstual të lirive dhe të drejtave të njeriut, gjë që përbënte një zhvendosje në praktikën gjyqësore austriake. Ky evolucion i aktivizmit gjyqësor austriak i dedikohet jo pak ndikimit të **GJKGje** dhe mënyrës se si ajo ka zbatuar parimin e proporcionalitetit në praktikë, duke promovuar parimin e barazisë, të arsyeshmërisë dhe të mbrojtjes së pritjeve legjitime në sferën e të drejtave dhe lirive individuale.[175]

Në rastin e **Brazilit**, aktivizmi gjyqësor shprehet në një mënyrë edhe më specifike, diçka që është parë më herët në vendet në tranzicion: **Kushtetuta e Brazilit** (1988), aktualisht në fuqi, ka parashikuar një katalog të gjerë të të drejtave, i cili më herët nuk ka ekzistuar, duke i dhënë të njëjtit fuqi normative të zbatueshme përmes rrugëve gjyqësore. **Tribunali Suprem Federal (TSFB)**, në këtë mes, zë një vend të veçantë. Në tridhjetë vitet e ekzistencës së Kushtetutës, ky organ nuk ka hezituar të jetë aktivist me qëllim të plotësimit të vakumit legjislativ, zbatimit të botëkuptimeve të forta mbi liritë dhe të drejtat kushtetuese dhe fuqinë e tyre normative, si dhe me qëllim të zgjerimit të kompasit të kontrollit të kushtetutshmërisë në sferat tjera, siç janë ndarja e pushtetit dhe organizimi vertikal i tij.

Në sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut, vlen të theksohet se **TSFB** ka qenë mjaft aktiv në promovimin e të drejtave të komunitetit **LGBT**, **abortit**, të drejtave të atyre që duan të bëjnë eksperimente shëndetësore dhe kështu me radhë. Krejt kjo, sikundër u tha, është bërë e mundur nga redaktimi i vetë tekstit të Kushtetutës së vitit 1988, e cila tani nuk interpretohet më në mënyrë formaliste, por në mënyrë normative dhe argumentative, jo rrallë duke u mbështetur edhe në argumente të tjera ekstra kushtetuese, në veçanti në sferën e lirive dhe të drejtave individuale në shoqërinë konservative braziliane.[176] Edhe në rastin e Brazilit, një ndikim të madh ka pasur **GJKGJe**.

---

174 Cf. seksioni 2.4 i kapitullit të dytë të librit.

175 Konrad Lachmayer, "The Austrian Constitutional Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 75-114, në fq. 75-80, 82-83, 90-91.

176 Conrado Hubner Mendes, "The Supreme Federal Tribunal of Brasil". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 115-153 në fq. 116-118.

Nisur nga fakti se **TSFB** ka juridiksion penal ndaj zyrtarëve të lartë shtetëror, aktivizmi gjyqësor në sferën penale spikatë më shumë se në atë kushtetuese. Në fushën kushtetuese, ky organ ka juridiksion origjinal, njëjtë si në sistemin amerikan. Një rast penal, i njohur si **rasti Mensalão**, në të cilin **TSFB** ka dënuar me burg disa funksionarë qeveritarë që kishin provuar blerjen e votave parlamentare në mënyrë korruptive si dhe për disa vepra të ngjashme të natyrës së cenimit të vullnetit të popullit, paraqet pikën nisëse për këtë aktivizëm gjyqësor në sferën penale.[177]

Nuk besoj të ketë një gjyqësi kushtetuese evropiane që më shumë i ngjason gjyqësisë kushtetuese kosovare se ajo në **Republikën e Çekisë**, në veçanti nëse kihet parasysh konteksti socio-kulturor dhe socio-politik pas rrënimit të komunizmit. I vetmi përjashtim është se në Kosovë ka pasur një dekadë e me shumë represioni e dhune shtetërore, e cila në fund ka përfunduar në konflikt të armatosur. Gjatë kësaj periudhe, kultura juridiko-kushtetuese e ish-Jugosllavisë është rrënuar në tërësi, në ndërkohë që në sistemin paralel të edukimit juridik kosovar është krijuar një elitë juridike që është arsimuar jashtë syve të kritikës shkencore dhe botës së mirëfilltë akademike. E thënë ndryshe, përveç kohës së sundimit brutal të diktatorit serb **Sllobodan Millosheviq**, rrethanat socio-politike dhe socio-kulturore ceke ngjasojnë shumë me rrethanat kosovare. Të shohim përciptazi cilësitë themelore të rastit të përvojës në **Republikën e Çekisë.**

Në kapitujt mbi historinë e gjyqësisë kushtetuese evropiane, pjesa e vendeve ish-komuniste, kemi diskutuar për Çekosllovakinë, ndarjen në dy shtete dhe themelimin e dy gjykatave kushtetuese, çeke dhe **sllovake.** Nga themelimi në vitin 1989 e deri në prishjen e saj në vitin 1992, **Gjykata Kushtetuese e Çekosllovakisë** nuk ka pasur ndonjë rekord të rasteve që vlejnë për t'i zënë në gojë në mënyrë specifike.[178] Vetëm pas krijimit të **Gjykatës Kushtetuese të Çekisë** (GJKÇe) vjen në shprehje tërë potenciali kreativ i këtij institucioni në trasimin e rrugës evropiane dhe të shkëputjes graduale nga kultura juridiko-kushtetuese e kohë së komunizmit. Në dekadën e parë të ekzistimit të saj, ajo ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në prishjen e praktikave të interpretimit tekstual të normës juridike, si pasojë e trashëgimisë komuniste. Në fillim, gjyqtarët e rregullt kanë rezistuar për të vënë në jetë vendimet e **GJKÇe**, me arsyetim se normat kushtetuese janë të komplikuara dhe kanë tjetër logjikë interpretimi dhe kuptimi, i cili është i pafund, i përgjithshëm dhe tërësisht i papërcaktuar ashtu që lë mundësi të pakufizuara interpretimi. Kjo gjendje tanimë ka ndryshuar, ashtu që gjyqësori i rregullt merr parasysh normat kushtetuese me rastin e çdo vendimmarrjeje, përfshirë këtu edhe interpretimet e dhëna nga **GJKÇe**.[179] Kjo në veçanti vjen në shprehje në sferën e implementimit të lirive dhe të drejtave kushtetuese.

Nën ndikimin e teorisë dhe praktikës gjermane, **GJKÇe** ka dhënë një kontribut të çmuar në sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut, duke shtypur formalizmin juridik dhe interpretimin tekstual që është trashëguar nga e kaluara. Këtu nuk e kemi fjalën jo vetëm për vënien në jetë të efektit vertikal të lirive dhe të drejtave kushtetuese, por edhe të atij horizontal: sot lirisht mund të thuhet se në këtë vend është instaluar praktika gjermane e **efektit horizontal** të lirive dhe të drejtave kushtetuese, nisur nga fakti se në çdo gjykim dhe vendosje për të drejtat e njeriut jashtë gjyqësisë kushtetuese, gjykatat dhe organet tjera ceke e kanë për detyrë të marrin parasysh dhe të balancojnë liritë dhe të drejtat kushtetuese. Në veçanti ka spikatur balancimi në mes të **lirisë së shprehjes** në rastet e **shpifjes dhe fyerjes** duke anuar në favor të lirisë së shprehjes si parakusht për zhvillimin demokratik të një shoqërie post-komuniste.[180]

---

[177] Cf. më shumë për historikun e këtij rasti në Vlaudia Maria Barbosa, "The Brasilian Supreme Court: Between Activism and Judicial Responsibility". I-CONET (December 25, 2012) Në internet: http://www.iconnectblog.com 2012/12/the-brazilian-supreme-court-Between-activism-and-judicialresponsibility/; Cf. po ashtu edhe Keith S. Rosenn, "Recent Important Decisions by the Brazilian Supreme Court". *The University of Miami Inter American law Review* Vol. 45, No. 2 (Spring 2014), fq. 297-334 (ku autori diskuton gjerësisht për vendimet kryesore të cilat shprehin aktivizmin gjyqyësor, si ato që kanë të bëjnë me komunitetin **LGBT, abortin anencefalik**, **legalizimi i veprimit afrimativ të shtetit në arsim**, ruajtjen e **Ligjit për Amnesti** të vitit 1979 që amnistonte zyrtarë të lartë shtetëror për kohën e diktaturës braziliane dhe kështu me radhë).

[178] Cf. më shumë në seksionin 5.2 të kapitullit të pestë të këtij libri.

[179] Zdenek Kuhn, "The Constitutional Court of the Czech Republic". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 199-235 .

[180] Ibid., fq. 201.

Për dallim nga gjyqësori i rregullt që mbështetet në kuptimin tekstual të normës, përvoja me gjyqësinë kushtetuese ka paraqitur një risi të madhe në sistemin e drejtësisë ceke: interpretimi i normës kushtetuese domosdo që është teleologjik dhe përfshinë balancimin e kujdesshëm dhe evolutiv të dy ose më shumë interesave në konflikt me njëri tjetrin. Kjo kërkon qasje kreative, shumë të thellë e të nuancuar, të liruar nga premisat dogmatike e formaliste, diçka kjo e huaj për arsimimin juridik cek të gjyqtarëve dhe prokurorëve të kohë së komunizmit. E thënë ndryshe, **silogjizmi gjyqësor** në sferën e gjyqësisë kushtetuese përbënte një risi dhe diçka të huaj. Të arsimuar në sistemin e vjetër, juristët cek nuk ishin në gjendje dhe as të gatshëm për t'u përshtatur vlerave të reja të gjyqësisë kushtetuese gjatë dekadës së parë të zhvillimit të saj pas rënies së komunizmit. Kjo ka ndryshuar vetëm pas dekadës së parë, ashtu që, tani gjyqtarët cek të gjyqësorit të rregullt çdoherë marrin parasysh përvojën e gjyqësisë kushtetuese dhe interpretimet e bëra nga ajo në sferën e lirive dhe drejtave të njeriut.

Në sferën e kontrollit abstrakt të normës si dhe të ushtrimit të juridiksioneve tjera në sferën e ndarjes së pushteteve dhe balancimin e tyre, **GJKÇe** po ashtu ka dhënë një kontribut të madh duke shërbyer si një avangardë institucionale në eliminimin e dënimit me vdekje, afirmimin e barazisë para ligjit, të drejtave të komunitetit **LGBT**, abortit dhe kështu me radhë. Krejt kjo është bërë e mundur falë tre faktorëve: e para, falë atmosferës post-komuniste liberale dhe orientimit të përgjithshëm euroatlantik të **Republikës së Çekisë**; e dyta, falë juridiksionit mjaft të gjerë të **GJKÇe**; dhe, e treta, falë kulturës juridike dhe traditës ceke në të kaluarën para-komuniste, në veçanti në mes të dy luftërave botërore. Këta faktorë, të marrë së bashku, qëndrojnë prapa suksesit në rrugën e integrimit euroatlantik të Çekisë.[181]

Askund më shumë se në **Francë** nuk kanë ekzistuar rezerva ndaj dhënies së gjyqësorit të çfarëdo roli normëvënës. Kjo situatë ka një histori dhe lidhet me formimin e kulturës kushtetuese franceze pas **Revolucionit të vitit 1789**. Në kohën e **ancien régime**, gjyqtarët francez kishin qenë shumë kreativë në normëvënien gjyqësore në funksion të krijimit të privilegjeve për vete dhe dinastinë **Burbon**. Me rrëzimin e saj dhe ngritjen graduale në pushtet të **Napoleonit** u pa se, megjithatë, eliminimi i tërësishëm i rolit të gjyqtarëve në interpretimin e normave ligjore dhe normave me rëndësi kushtetuese (p.sh. Deklarata mbi Liritë dhe të Drejtat e Njeriut dhe të Qytetarit e v. 1789) nuk përbënte një mundësi reale. Për të penguar ringritjen e tërësishme të rolit të gjyqtarëve, **Napoleoni** nisi atë që më vonë u cilësua si kultura juridike e kodifikimit: i bindur se gjyqtarët duhet të jenë asgjë më shumë se goja e ligjit (**bouche de la loi)**, ai urdhëroi kodifikimin e pjesës dërrmuese të aktivitetit shoqëror të **Francës** së re, kulturë që më pas u përhap në tërë botën e qytetëruar për t'u bërë standardi juridik i saj.

Kjo përpjekje nuk zgjati shumë: në ndërkohë që shekulli XIX ende e ruante të freskët rolin dhe pozitën e privilegjuar të gjyqtarëve francezë, fillimi i shekullit XX sikur harroi traditën e **ancien régime** dhe rolin që gjyqësori kishte pasur.[182] Në të njëjtën kohë, pat autorë juridik francez, por edhe nga elita tjetër, që u përpoqën ta emitonin praktikën amerikane të gjyqësisë kushtetuese, duke u angazhuar për një rol më aktiv të gjyqësorit. Kjo përpjekje, megjithatë, ndaloi në vitin 1921, kur fitoi pikëpamja e vjetër anti-aktiviste që i mohonte çdo rol normëvënës gjyqësorit francez. Këtë vit doli nga shtypi libri më me ndikim afatgjatë në **Francë** sa i përket rolit dhe pozitë së gjyqësorit, libri **Le gouvernement des juges et la lutte contre la législation sociale aux États-Unis**, i autorit Edvard Lambert (**Edouard Lambert: 1866-1947**). Në këtë libër, autori shpreh rezerva kolosale ndaj rikthimit të **anien regime** apo, siç e ka quajtur ai, në **qeverisje prej gjyqtarëve**, e cila, sipas tij, ekzistonte në SHBA. Më pas, kjo shprehje mori dhenë dhe u bë kanon i ditës në diskursin juridik dhe kushtetues francez, kryesisht si pasojë e jehonës që pati në Francë roli aktivist i **Gjykatës Supreme të SHBA** Në kohën për të cilën po flasim, dhe të cilën e ka pasur parasysh Edouard Lambert, Gjykata Supreme e SHBA kishte rrëzuar disa ligje mjaft progresive për

[181] Shannon Ishiyama Smithey and John Ishiyama**,** "Judicial Activism in Post-Communist Politics" *law & Society Review* Vol. 36, No. 4 (2002), fq. 719-742; Marcin Matczak, Matyas Bencze and Zdenek Kuhn, "Constitutions, EU law and Judicial Strategies in the Czech Republic, Hungary and Poland" *Journal of Public Policy* Vol. 30 Issue 1 (April 2010) fq. 81-99.

[182] Arthur Dyevre, "The French Constitutional Council" . Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 323-355 në fq. 323-328.

kohën, duke penguar qeverinë amerikane në ligjvënie përgjatë shumicës së kohës ndërmjet dy luftërave botërore.[183] Kjo kohë njihet ndryshe si **Lochner Era** (1897- 1937).[184]

Kur u themelua **Këshilli Kushtetuese i Francës/Conseil Constitutinnel** (KKFr), siç e kemi theksuar në pjesën historike kur kemi folur për **Francën**,[185] nuk ka qenë qëllimi që ky organ të luaj rolin e një gjykate kushtetuese. Krejt e kundërta: forma, juridiksioni dhe organizimi i tij i brendshëm çonin në përfundimin se bëhej fjalë për një organ të ri, një risi, në sistemin kushtetues francez. Vetë emri i tij, "këshill", një gjysmë-gjykatë, as gjykatë e as tribunal administrativ, fliste shumë, siç fliste edhe fakti se ai nuk u fut në kuadër të sistemit gjyqësor francez. Esenca e themelimit të tij ka qenë për të shërbyer si nj lloj frenuesi i pushtetit legjislativ dhe mbrojtës i ekzekutivit të ri francez, i cili udhëhiqej nga **Presidenti Sharl De Gol** (**Charles de Gaule**: 1890-1970). Shumë më vonë, kultura juridike dhe kushtetuese franceze e shndërroi këtë institucion në një trup me tipare të qarta të një gjykate kushtetuese. Vendimi i parë në këtë drejtim është marrë në fillim të viteve '70-të të shekullit të kaluar, i njohur si **Liria e Asociimit**. Me këtë rast, **KKFr** tha se nuk ishte vetëm **Kushtetuta e Republikës së Pestë** (1958) si burim i së drejtës kushtetuese dhe si parametër për vendosje, por edhe **Preambula e Kushtetutës së Republikës së Katërt** (1946) dhe, përmes saj, edhe **Deklarata mbi të Drejtat e njeriut dhe të Qytetarit** (1789). Këto burime të reja u njohën me shkurtesën e njohur si **Parimet Fundamentale të Njohura nga Ligjet e Republikës (Principes fondamentaux reconnus par les lois de la République**: **PFRLR**).[186]

Kontrolli preventiv, si juridiksion themelor që ka dalluar **KKFr** nga organet tjera që nga themelimi i tij, nuk kishte qëllim tjetër pos frenimin e ligjvënësit francez kundrejt ndërhyrjes në prerogativat e reja të ekzekutivit nacional. Ky juridiksion, megjithatë, nuk pati ndonjë histori të pasur për t'u lënë si trashëgimi, deri në vitin 1974 kur **KKFr** papritur mori një hov kur një grupi të caktuar të deputetëve iu njoh e drejta për të iniciuar procedurat pranë tij. Deri atëherë këtë të drejtë e kanë pasur vetëm shefi i ekzekutivit, shefi i shtetit dhe kryetarët e dy dhomave të **Parlamentit të Francës**. Një juridiksion i tillë akoma nuk i jepte të drejtë atij që të luante ndonjë rol të madh në sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut, ani se vendimi i sipërcekur për **Lirinë e Asocimit** kishte bërë një hap para në këtë drejtim. Një kthesë në këtë drejtim do të vije shumë më vonë: në vitin 2008 u bë një reformë, e cila hyri në fuqi në mars të vitit 2010, e cila ia njohu **KKFr** të drejtën e procedimit sipas kërkesave të dy gjykatave më të larta franceze në procedurat e kontrollit konkret (incidental), të kushtetutshmërisë së ligjeve në fuqi.

Që nga kjo kohë, kontrolli represiv përmes **rrugës incidentale** ka marrë shumicën e kohës dhe punës së këtij organi, duke shërbyer si mekanizëm kryesor për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave kushtetuese përmes gjyqësisë kushtetuese (më herët vetëm gjykatat administrative franceze kanë pasur të drejtë të anulojnë vendimet mbi bazën e cenimit të lirive dhe të drejtave kushtetuese). Ky model u fut në kulturën kushtetuese franceze si pasojë e ndikimit që ka pasur e drejta kushtetuese komparative: futja e **kontrollit incidental** të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe normave tjera juridike në sistemin kushtetues francez i

---

183 Edouard Lambert, *Le gouvernement des juges et la lutte contre la législation sociale aux États-Unis. L'expérience américaine du contrôle judiciaire de la constitutionnalité des lois* (Girard & Cie: Paris, 1921) . Cf. më shumë për komentet e këtij libri, recensionet si vijon: Max Radin, "Le Gouvernement des Juges et la Lutte Contre la Législation Sociale aux Etats-Unis by Edouard Lambert" *California law Review* Vol. 11, No. 1 (Nov., 1922), fq. 63-67; Luc Heuschling, "Edouard Lambert. Le gouvernement des juges et la lutte contre la législation sociale aux États-Unis. L'expérience américaine du contrôle judiciaire de la constitutionnalité des lois". *Revue internationale de droit comparé.* Vol. 59 N°4 (2007) fq. 958-961.

184 Në këtë kohë, **Gjykata Supreme e SHBA**-ve ka mënjanuar shumë ligje që kanë pasur të bëjnë me sistemin ekonomik amerikan, duke përdorur argumentet dhe vlerësimet e veta, në vend të atyre të Kongresit Amerikan, për të gjykuar lidhur me kushtetutshmërinë e politikave ekonomike të qeverive amerikane të kohës. Si bazë për mënjanimin janë përdorur argumenti dhe vlerësimi i Gjykatës Supreme sipas së cilës ligjet e caktuara ekonomike po cenimin lirinë ekonomike dhe të drejtat private kontraktuale të palëve (liria e kontraktimit në rend të parë). Cf. më shumë për këtë kohë të aktivizmit gjyqësor dhe arsyet për zëvendësimin e pikëpamjeve të gjyqtarëve amerikan me politikat ekonomike të Kongresit në këtë kohë, në Barry Cushman, "Teaching the Lochner Era". *Saint Louis University law Journal* Vol. 62 No. 3 (Spring 2018) fq. 537-567.

185 Cf. më shumë në seksionin 2.2 të kapitullit të dytë.

186 Xavier Aurey, Anne-Sophie Denolle, Marie Rota and Vincent Souty, "French Constitutional law Chronicle: January 2007 - March 2008*".* ***Revus.*** *Journal for Constitutional Theory and Philosophy of law/Revija za ustavno teorijo in filozofijo prava*. 7|2008 **(**Legitimnost ustavnosodnega odločanja) fq. 101-109.

dedikohet kryesisht përpjekjeve të këtij vendi për të përafruar me **Strasburgun** praktikën e vet të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave kushtetuese përmes gjyqësisë kushtetuese, njëjtë siç kanë jurisprudencën shumica e vendeve evropiane (p.sh. Britania e Madhe ka miratuar në vitin 1998 "Human Rights Act" për të internalizuar në tërësi dispozitat e KEDNJ në sistemin kushtetues britanik).[187] Kjo procedurë njihet si "çështja paraprake e kushtetutshmërisë"("La question prioritaire de *constitutionnalité" ose "QPC"*), për të cilën kemi diskutuar gjetiu, ashtu që këtu nuk do të flasim më shumë.[188]

Konteksti kulturor **gjerman** brenda të cilit është zhvilluar gjyqësia kushtetuese ngërthen specifika më të sofistikuara krahasuar me krejt përvojën e vendeve të tjera perëndimore. Në kapitujt pararendës kemi shtjelluar historinë institucionale të lindjes dhe zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese gjermane, si dhe faktorët rrethanor që kanë çuar në lindjen e **GJKGje.** Këtu nuk flasim më shumë për këtë aspekt, për t'u ndalur kryesisht në kontekstin kulturor të ushtrimit të gjyqësisë kushtetuese gjermane, e cila ka shërbyer si model jo vetëm për vendet evropiane post-komuniste, por edhe vendet tjera si **Spanja, Portugalia** dhe disa vende të **Amerikës Latine**. Fillimisht ka qenë ideja që në Gjermani të futet një gjyqësie kushtetuese sipas modelit amerikan. Në fund u hoq dorë nga kjo ide.

Ligji Themelor i Gjermanisë Gjerman (**LTH**) nuk ka reflektuar ndonjë shpirt kushtetues të kohës së vet, sepse një i tillë nuk ka ekzistuar. Më tepër është parë si një dokument i përkohshëm që reflekton tërë situatën tragjike dhe kaosin në të cilën gjendej vendi. Pikërisht për këtë, **LTH** u cilësua si një dokument i përkohshëm që ka për mision tejkalimin e situatës së kaosit dhe anarkisë së pasluftës. Ai në veçanti nuk u parashikua të jetë një dokument transformues i shoqërisë gjermane:[189]ajo që ka dominuar diskutimin gjatë procesit të draftimit të **LTH** ka pasur të bëjë me futjen e dispozitave që ngërthejnë pengimin e rikthimit në të kaluarën. Kjo do të thotë se teksti i tij më shumë ka pasur shikim retrospektiv se prospektiv dhe transformues. Kjo në mënyrë të veçantë shihet nëse analizohen me kujdes dispozitat e tij që nuk mund të amendamentohen. Ato gjenden në nenin 79.3 ["Amendamentimi i Ligjit Themelor"] dhe kanë të bëjnë me rregullimin federal të shtetit nëpër **land**-e, pjesëmarrjen e **land**-eve në ligjvënien federale, fuqinë juridikisht të detyrueshme të lirive dhe të drejtave kushtetuese dhe, në fund, me demokracinë dhe shtetin social.

LTH u cilësua si një dokument i përkohshëm me shpresën se një ditë do të ndodhë ribashkimi i kombit gjerman, i cili do të nxirrte kushtetutën e vet përfundimtare. Kjo, megjithatë, nuk ka ndodhur ani se bashkimi ka përfunduar: sot e kësaj dite ekziston **LTH** i kohës së pas Luftës së Dytë Botërore, me amendamentimet përkatëse që, në thelb, nuk ndryshojnë parimet bazë dhe vlerat mbi të cilat ai u ndërtua fillimisht. Përkundër faktit se ka qenë një dokument i imponuar nga forcat okupuese të fuqive aleate pas Luftës së Dytë Botërore, njëjtë si në Japoni, në shoqërinë gjermane **LTH** ka luajtur një rol të rëndësishëm. Me kalimin e kohës është pranuar si kornizë juridike e veprimit brenda së cilës ka prosperuar shoqëria gjermane. Nuk ka rëndësi që qëllimi fillestar i nxjerrjes së tij nuk ka qenë transformues, por pengues i rikthimit të diktaturave të kaluara dhe tejkalimi i situatës së kaosit dhe anarkisë së pasluftës. Me kohë, **LTH** ka marrë cilësitë transformuese që në fillim nuk i ka pasur.

Në Gjermani, në fillim nuk ka pasur ndonjë entuziazëm për themelimin e një gjykate të ndarë kushtetuese, duke besuar se mjafton që të ekzistoj një organ që merret ekskluzivisht me vetëm me konfliktet për kompetencë, siç kishte qenë **Staatsgerichtshof** (**Gjykata Shtetërore e Rajhut Gjerman**).[190] Kjo, megjithatë,

---

187 Cf. më shumë për këtë në Myriam Hunter-Henin, Constitutional Developments and Human Rights in France: One Step Forward, Two Steps Back, *The International and Comparative law Quarterly* Vol. 60, No. 1 (January 2011) fq. 167-188 (ku autori tregon për synimin parësor të reformës së vitit 2008 që ka të bëj me sigurimin e supremacisë së Kushtetutës, kurse si efekt anësor ka dalë mbrojtja e lirive dhe të drejtave kushtetuese; u mor vesh, në **Francë** edhe më parë ka ekzistuar kjo mbrojtje, duke pasur për bazë **KEDNJ**, si një akt i ratifikuar që zbatohet drejtpërdrejt sipas nenit 55 të **Kushtetutës së Francës**).

188 Cf. më shumë në seksionin 2.2 të kapitullit të dytë.

189 Inga Markovits, "Constitution Making After National Catastrophes: Germany in 1949 and 1990" *William & Mary law Rev* Vol. 49 Issue 9 (2008), fq. 1307-1346 në fq. 1308-1309, 1312.

190 Michaela Hailbronner and Stefan Martini, "The German Federal Constitutional Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 356-393 në fq. 359.

nuk mjaftoi: në fund u vendos për themelimin e një gjykate të ndarë kushtetuese, **GJKGje**, cila nuk do të jetë krejtësisht klasike kelesniane. Kjo për shkak se vënia në jetë, përmes rrugës gjyqësore, të lirive dhe të drejtave të njeriut, të cilat u sanksionuan në kapitullin e parë të **LTH**, u bë për të mos përsëritur gabimet e **Republikës së Vajmarit**. Kjo qasje e re, përkatësisht vënia në jetë e lirive dhe të drejtave kushtetuese përmes mekanizmit gjyqësor të gjyqësisë së ndarë kushtetuese paraqiti një risi evolutive, që as nuk mund të paramendohej në kohën e **Hans Kelsen**.

Përveç kësaj, risitë në sistemin kushtetues gjerman ishin edhe në sferën e sistemit qeverisës: shefi i shtetit gjerman u reduktua në një institucion krejt formal dhe ceremonial pa asnjë kompetencë ekzekutive, u parashikua e drejta për rezistencë të gjermanëve, e njohur si "demokracia militante", në rastet kur ndokush synon uzurpimin e pushtetit demokratik të popullit. Krejt këto risi u futën në sistemin kushtetues gjerman si pasojë e përvojë së hidhur së gjermanëve me **Nacional-Socializmin** dhe **Adolf Hitler**-in.[191]

Në kohën e nxjerrjes së **LTH**, përpjekja e elitës gjermane ka qenë e fokusuar në rikthimin e traditës gjermane e **Rechsstaat** e shekullit XIX. Kjo synohej në një klimë në të cilën defilonin tri rryma me shumë ndikim: pozitivizmi i **Hans Kelsen**, integracionizmi i **Rudolf Smend** dhe etatizmi i **Karl Shmit**. Për aq sa bëhet fjalë për supremacinë (epërsinë) e **LTH**, ka dominuar teoria e pastër e së drejtës e **Hans Kelsen** dhe e ndarjes graduale evolutive të së drejtës nga politika, në ndërkohë që ndikimi i **Rudolf Smend** u pa si një doktrinë mbështetëse në rastin **Lüth**, nisur nga fakti se ky rast ndërtoi kuptimin integral të konstitucionalzimit gjerman në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut, të cilat të gjithë duhet t'i respektojnë dhe zbatojnë, përfshirë këtu në marrëdhëniet në mes të individëve (i a.q. **efekti rrezatues** i lirive dhe të drejtave të njeriut, i diskutuar më herët kur është folur për rastin **Lüth**).[192] Sa i përket raportit të **Gjermanisë** me **Evropës**, ka dominuar dhe akoma dominon mendimi i **Karl Shmit** dhe pikëpamjet e tij mbi Gjermaninë si një komb në mesin e kombeve të tjera të Evropës. Kjo pikëpamje ka ardhur në shprehje, për herë të parë, te realizimi i të drejtës për votë në nivel komunal, ku vetëm gjermanëve iu njoh një e drejtë e tillë.[193]Më vonë, si pikëpamje ka ardhur në shprehje edhe në rastet e vendimeve të **GJKGje** që kanë të bëjnë me integrimet evropiane dhe vendin e Gjermanisë në to, ku qartë u vu në spikamë sovraniteti gjerman dhe identiteti kushtetues i këtij vendi. Këto vendime e bënë të qartë se do të konsiderohen jokushtetuese veprimet e organeve të shtetit gjerman që kanë natyrë **ultra vires**. Këtë natyrë ato e kanë çdoherë kur cenojnë identitetin kushtetues gjerman. Ai identitet ankorohet kryesisht në dispozitat e sipërcekura kushtetuese që në asnjë rrethanë nuk mund t'i nënshtrohen dhe nuk mund të jenë objekt i amendamentimit kushtetues (të a.q. **dispozitat a paamendamentueshme kushtetuese**).

Një tjetër cilësi e kohës së pasluftës që ka të bëjë me gjyqësinë kushtetuese gjermane ka qenë edhe dhënia e kompetencave shumë të gjëra dhe specifike **GJKGje**, në veçanti ato që kanë të bëjnë me autorizimin për të kontrolluar dhe ndaluar aktivitetin e partive politike. Edhe kjo praktikë e re shërben si një dëshmi e gjallë për frikën gjermane nga restaurimi i diktaturave të kohës së shkuar.

Të gjitha risitë si më sipër nuk janë ato që i kanë dhënë vulën identitetit të veçantë të gjyqësisë kushtetuese gjermane. Cilësia më specifike e tërë ambientit kulturor kushtetues gjerman pas Luftës së Dytë Botërore ka të bëj me instalimin e mekanizmit të **ankesës kushtetuese**. Ky mekanizëm nuk u fut përmes **LTH**, megjithatë. Ai u sanksionua, jo me shumë entuziazëm, përmes dispozitave të **Ligji për Gjykatën Kushtetuese** në vitin tanimë të largët 1951. Për një kohë të shkurtër prej disa dekadave, ky mjet juridik ndërtoi doktrina e praktika, si p.sh. **doktrina e rendit objektiv juridik** të lirive dhe të drejtave kushtetuese dhe **parimi i proporcionalitetit**, të cilat lartësuan dinjitetin e njeriut gjerman, duke iu dhënë kuptim konkret efektiv normativ dispozitave mbi liritë dhe të drejtat kushtetuese. Ky model u bë shembull në tërë botën.[194]

---

[191] Ibid., fq. 357.

[192] Cf. më shumë në seksionin 11.3.9 të kapitullit të njëmbëdhjetë.

[193] Michaela Hailbronner and Stefan Martini, "The German Federal Constitutional Court", fq. 358-359.

[194] Ibid., fq. 398-391.

GKGje ka carë rrugën e saj duke ushtruar juridiksionin e dhënë me **LTH** dhe Ligjin për Gjykatën Kushtetuese në mënyrë shumë profesionale, agresive dhe të vendosur. Mjafton me këtë rast të ripërsërisim se deri më sot, ajo ka luajtur rol transformues në shoqërinë gjermane, në veçanti sa i përket aspektit të lirive dhe të drejtave të njeriut, të cilat përfundimisht në këtë vend konsiderohen si një **rend objektiv juridik** që përshkon çdo pore të sistemit juridik gjerman. Kjo është bërë e mundur përmes interpretimit ofenziv të juridiksionit të Gjykatës në sferën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave kushtetuese, ku një rol të veçantë e ka luajtur edhe **parimi i proporcionalitetit**, si një invencion i praktikës dhe teorisë gjermane. Bazuar në këtë parim, Gjykata ka ndërtuar teorinë dhe praktikën mbi korpusin e lirive dhe të drejtave të njeriut si një **rend objektiv juridik**, praktikë kjo e nisur me rastin **Luth** dhe që sot nuk kontestohet nga askush: çdo gjykatë e rregullt dhe çdo institucion publik ka për detyrë që me rastin e vendosjes për liritë dhe të drejtat kushtetuese të ketë parasysh efektin rrezatues të këtyre lirive dhe të drejtave ashtu që çdoherë t'iu jepet përparësi në raport me çdo trajtim dhe status të tyre ligjor dhe tjetër që ato kanë në sistemin juridik gjerman. Kjo ka nisur në fillim përmes lirisë së shprehjes, kur **GJKGje** tha se kjo e drejtë prevalon ndaj të drejtave civile për dëmshpërblim dhe të drejtave tjera të garantuara me **Kodin Civil të Gjermanisë**, për t'u përhapur më pastaj si një standard i ri kundrejt të gjitha aspekteve tjera të lirive dhe të drejtave kushtetuese[195].

Në kuadër të gjykatave më aktiviste të Evropës hyn, pa asnjë dyshim, **Gjykata Kushtetuese e Hungarisë (GJKHu**). U mor vesh, kjo ka të bëj me kohën para se të vijë në pushtet qeveria aktuale e kryeministrit **Viktor Orban**, e cila në ndërkohë ka nxjerr një infrastrukturë ligjore që dukshëm ia ka shkurtuar juridiksionin dhe autorizimet.[196] Këtë e kemi sqaruar më herët[197].

Askund më shumë se në Hungari nuk është vërejtur ndikimi i kulturës juridike komuniste në gjyqësinë kushtetuese: në periudhën prej vitit 1990 - 1998, nën mandatin e kryetarit të saj të parë, ***László Sólyom***, **GJKHu** ka qenë mjaft aktiviste dhe i ka ikur interpretimit tekstual. Në fakt, në këtë periudhë, ajo ka krijuar konceptin e **kushtetutës së padukshme** (**invisible constitution**), sipas së cilës Kushtetuta paraqet një dokument gjithëpërfshirës dhe koherent që ofron përgjigje ndaj çdo çështjeje kushtetuese, ani se nganjëherë këto përgjigje janë implicite dhe duhet të jesh shumë kreativ për t'i detektuar.

Interpretimi tekstual, ndërkaq, ka ardhur më shumë në shprehje pas vitit 1998. Ky vit shënon vijën ndarëse në mes të dy periudhave të rëndësishme në zhvillimin e gjyqësisë kushtetuese hungareze dhe kulturën e interpretimit juridik. Kjo do të thotë se koincidon me ikjen në vitin 1998 të kryetarit të parë të **GJKHu**, ***László Sólyom***, dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të ri. Përfundimi i periudhës së aktivizmit është parë që në vendimet e para pas marrjes së lidershipit nga **Janos Nemeth**, profesor i procedurës civile.[198] Këtu e tutje nis të rikthehet formalizmi dhe interpretimi tekstual, i cili nuk e merr parasysh qëllimin objektiv të ligjit në shoqëri.[199] Sipas interpretimit tekstual, teksti kushtetues duhet të jetë çdoherë bazë: çka nuk gjendet në tekst nuk mund të zbulohet nga ana e gjyqtarëve kushtetues. Kjo traditë komuniste ka qenë, siç u tha, më pak e theksuar në mandatin e parë, duke ardhur në shprehje pas vitit 1998 kur ka ndryshuar përbërja e **GJKHu** dhe stafimi i saj me kuadro të edukuar në kohën e komunizmit. Në logjik-

---

195 Michaela Hailbronner and Stefan Martini, "The German Federal Constitutional Court", fq. 358, 360.

196 Menjëherë pas ardhjes në pushtet në vitin 2010, Viktor Orban ka inicuar ndryshimet kushtetuese për t'ia ndaluar Gjykatës Kushtetuese kontrollin kushtetues të ligjvënies në sferën e taksave dhe të financave shtetërore. Kjo qasje, e implementuar që nga vitit 2010, është kritikuar ashpër. Cf. *3rdCongress of the World Conference on Constitutional Justice "Constitutional Justice and Social Integration". 28 September – 1 October 2014 . Seoul, Republic of Korea. Questionnaire. Reply by the Constitutional Court of Hungary. Fusnota nr. 8 dhe teksti që e shoqëron***.** Në internet: https://www.venice.coe. int/ WCCJ/ Seoul / docs/ Hungary_CC _ reply questionnaire3WCCJ-E.pdf (shikuar së fundi në maj 2019).

197 Cf. më shumë në seksionin 5.2 të kapitullit të pestë.

198 Cf. më shumë për rikthimin në formalizëm tekstual në praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë në Kim Lane Scheppele, The New Hungarian Constitutional Court. After Solyom, Retreat into Formalism?" *East European Constitutional Review* Vol. 81 No. 1 (Fall 1999) fq. 81-87; Kim Lane Scheppele, "Constitutional Negotiations: Political Contexts of Judicial Activism in Post-Soviet Europe". *International Sociology* Vol. 18 No. 1 (March 2003) fq. 219 – 238.

199 András Jakab - Johanna Fröhlich, "The Constitutional Court of Hungary". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 394-437 në fq. 394-405.

ën komuniste kushtetuta është vetëm një tekst deklarativ që nuk ka asnjë vlerë normative. Ky ka qenë botëkuptimi dominant në kulturën kushtetues hungareze kur është themeluar **GJKHu** në vitin 1989. Për pasojë, çdo vendim i saj në vitet e para formative shihej si aktivizëm gjyqësor nga ana doktrinarëve të edukuar në universin juridik komunist. Juristët e kësaj kohe, ta zëmë, nuk e kishin të qartë se **GJKHu** duhet të zgjedh problemet e konfliktit për kompetencë, si dhe problemet tjera të kushtetutshmërisë së ligjeve, zgjidhja e të cilave në kohën e vjetër kishte qenë prerogativë e partisë komuniste.

Kjo logjikë komuniste është ruajtur edhe sot e kësaj dite: vendimet e **GJKHu** kritikohen nga ata që nuk u pëlqejnë, kurse tjerët i lavdërojnë pa i lexuar asnjëherë, në mënyre krejt retorike. Kur duhet vënë në jetë, ndodhë që vendimet nuk internalizohen, përkatësisht nuk ndërmerren hapa konkret në vijim të zbatimit të tyre. Kjo në veçanti vlen për vendimet që kanë të bëjnë me lëshimet (emetimet) kushtetuese, ku **Parlamenti i Hungarisë** nuk merret fare me udhëzimet dhe urdhrat e **GJKHu** të shprehura në vendimet e saj.[200]

Një faktor tjetër që ka ndikuar në aktivizmin fillestar të **GJKHu** ka qenë edhe fakti i ekzistimit të **actio popularis**. Ky mjet juridik ka ekzistuar përgjatë dy dekadave të gjyqësisë kushtetuese hungareze, deri në vitin 2012. Shumica e rasteve janë krijuar përmes **actio popularis**, sepse pala nuk ka pasur nevojë fare të provojë ekzistimin e interesit juridik për hapjen e procedurave pranë saj. Me reformat kushtetuese të vitit 2012 është abroguar **actio popularis** dhe është futur mjeti juridik i **ankesës së plotë kushtetuese**, i modeluar sipas praktikës gjermane, ku kërkohet plotësimi i kushteve për lejueshmërinë e saj, përfshirë këtu dëshminë e ekzistimit të interesit juridik për ushtrimin e ankesës.[201]

Sidoqoftë, mendim i përgjithshëm është se **GJKHu** ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në hapjen e rrugës së integrimit euroatlantik të vendit përmes sfidimit të ligjvënësit hungarez, duke e detyruar atë që të ndjekë harmonizimin e produkteve të veta me ***acquis communautaire*** të **BE**-së.[202]

Situata e përgjithshme në **Itali** pas **Luftës së Dytë Botërore** nuk dallon dukshëm nga ajo e Austrisë dhe Gjermanisë, nisur nga fakti se, së bashku, tri këto vende, kanë kaluar nëpër diktatura të ashpra. Kjo gjendje ka shtruar nevojën e pasjes së institucioneve të reja dhe të forta, përfshirë gjykatat e reja kushtetuese, që do të ndihmonin implementimin e kushtetutave të reja, vlerave e parimeve që ato ngërthenin. E njëjta vlen edhe për **Spanjën**, e cila ka pasur një kulturë juridike pak a shumë të ngjashme me vendet si më sipër, si dhe një diktaturë të ashpër që ka shtruar nevojën e formimit të një institucioni që do të arbitronte në luftën për pushtet dhe të mbronte rolin e ri të individit në shoqëri, pas shkatërrimit të diktaturës së **Gjeneralit Franko**.

Kultura juridike italiane e kohë së **Fashizmit** ka lënë vragë të mëdha në sistemin juridik italian: shumë kohë pas Luftës së Dytë Botërore, **GJKIt** ka vendosur për kushtetutshmërinë e ligjeve të kohës së diktatorit **Benito Musolini** (1883-1945).Përveç kësaj, jo pak gjyqtarë kishin shërbyer në gjyqësinë e diktatorit italian, rrethanë që objektivisht shtronte nevojën e ndërtimit të një sistemit të ri juridik-kushtetues, të një gjyqësori të rregullt që bazohet në një botëkuptimi të ri për kushtetutën dhe formën e qeverisjes që u sanksionua me **Kushtetutën e Italisë** (1948). Në këtë kuptim, roli aktivist i **GJKIt**, e cila u bë op-

---

200 Ibid., fq. 400-401.

201 Kjo parashikohet në pjesën e 9-të të kapitullin të dytë të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Hungarisë. Cf. Act CLI of 2011 on the Constitutional Court. Në internet: https://hunconcourt.hu/rules/act-on-the-cc (shikuar së fundi në maj 2019); Për komentet, shih më shumënë: European Commission for Democracy Through law (Venice Commission), *Opinion on Act CLI of 2011 on the Constitutional Court of Hungary.* Adopted by the Venice Commission at its 91st Plenary Session (Venice, 15-16 June 2012). Strasbourg, 19 June 2012. Opinion no. 665 / 2012 CDL-AD(2012)009. Or. Engl. Parag.: 26-33; Fruzsina Gárdos-Orosz, "The Hungarian Constitutional Court in Transition – from Actio Popularis to Constitutional Complaint." *Acta Juridica Hungarica* Vol. 53 No. 4 (December 2012) fq. 302-315.

202 Christian Boulanger, "Europeanization Through Judicial Activism? The Hungarian Constitutional Court's Legitimacy and the 'Return to Europe'." Në Wojciech Sadurski, Adam Czarnota, Martin Krygier (eds.), *Spreading Democracy and the Rule of law? The Impact of EU Enlargement for the Rule of law, Democracy and Constitutionalism in Post-Communist Legal Orders* (SPRINGER: Dordrecht, the Netherlands, 2006) fq. 263-280.

eracionale në vitit 1956, ani se Kushtetuta parashikonte themelimin e saj që atëherë, ka qenë kolosal dhe këtë e kemi shpjeguar më herët në këtë kapitull kur kemi bërë fjalë për diversitetin e teknikave të interpretimit.[203] Kjo vlen në veçanti sa i përket rolit të saj në disiplinimin e gjyqësorit të rregulltë, i cili ishte shumë dogmatik dhe dominohej nga kultura e vjetër juridike e kohë së **Fashizmit.**[204]

Ndërtimi i gjyqësisë së ndarë kushtetuese në **Itali** përbënte një sfidë të re, sepse bëhej fjalë për një organizëm që duhej të kujdesej për vënien në jetë të demokracisë kushtetuese, ku pushteti buron nga populli por ushtrohet sipas dispozitave kushtetuese dhe brenda kuadrit të paracaktuar kushtetues. Kjo ishte një përvojë të panjohur për shoqërinë italiane të kohës, që edhe më shumë u reflektua në sferën e lirive dhe të drejtave kushtetuese. Roli dhe pozita e individit në këtë mes u bënë shumë të qarta dhe garantoheshin me Kushtetutë, në të cilën gjendet një katalog mjaft të pasur të lirive dhe të drejtave të njeriut. Kushtetuta përfundimisht kuptohej si një tekst normativ, kurse mekanizimi i kontrolli kushtetues të ligjeve shërbente si një instrument i ri për të promovuar rolin dhe pozitën e re të njeriut në shoqërinë italiane.[205]

GJKIt nuk ka mekanizëm të ankesës kushtetuese. Juridiksioni i saj është kryesisht në sferën e kontrollit abstrakt dhe konkret të kushtetutshmërisë së normave juridike. Në këtë sferë, në veçanti ka rëndësi të theksohet se "lënda e parë" e këtij kontrolli vjen përmes procedurave të kontrollit incidental të kushtetutshmërisë së normave juridike, të iniciuara nga gjyqësori i rregullt. Në këtë proces ndërveprimi, **GKIt** ka ushtruar ndikim të thellë dhe të pashlyeshëm në ndryshimin e kulturës dogmatike të interpretimit tekstual të ligjeve dhe normave të tjera të përgjithshme nga gjyqësori i rregullt. Në fillim ka pasur keqkuptime dhe luftë në mes të saj dhe gjykatave të rregullta. Kjo gjendje me kohë është ndrequr ashtu që, aktualisht, respektimi i Kushtetutës nga gjyqësori i rregullt është përtej çdo dyshimi. Ky gjyqësor vepron në pajtim me standardet e krijuara nga **GJKIt** përmes jurisprudencës së saj të pasur. Përveç aktivizmit gjatë kontrollit incidental të normave juridike, në sferën e zgjidhjes së konflikteve për kompetencë dhe në sferat tjera, po ashtu ka pasur një dozë aktivizmi, mirëpo jo si në fushat e sipërcekura.[206]

Në literaturë, me të drejtë është vërejtur se, në përgjithësi, konstitucionalizmi italian është zhvilluar jashtë parametrave të ngurtë kushtetues, të cilët nuk lejojnë amendamentimet e Kushtetutës që prekin substancën e identitetit kushtetues italian. Kjo ka ndodhur në veçanti përmes nxjerrjes së ligjeve të zakonshme që përmbajnë norma kushtetuese, si p.sh. ligjet zgjedhore, konventat kushtetuese, instrumentet juridike të së drejtës evropiane dhe, së fundi, vendimet e rëndësishme të GJKIt që kanë pasur të bëjnë me mosdiskriminimin, barazinë para ligjit dhe kategoritë tjera kushtetuese, siç janë ndarja dhe balancimi i pushteteve dhe sferat tjera kushtetuese. Ky zhvillim kësisoj i konstitucionalizmit italian i dedikohet dy faktorëve**, kulturës kushtetuese italiane** dhe **sistemit politik italian**.[207]

Sa i përket **kulturës kushtetuese**, vlen të theksohet se Italia përbën një rast më specifik se **Austria** dhe **Gjermania**: në këtë vend, që nga **Asambleja Kushtetuese**, diskursi juridik është dominuar nga autorët prominentë që kanë marrë pjesë në Asamble dhe kanë shërbyer më pas si gjyqtarë kushtetues. E kemi fjalën për autorin **Costantino Mortati** dhe librin e tij me mjaft ndikim **La Cos-**

---

[203] Cf. Seksioni 14.4, **supra**, pjesa që flet për **Italinë** (në vecanti pjesa për **diritto vivente**).

[204] Për një shtjellim të shkëlqyer të zhvillimit historik të kulturës kushtetuese dhe juridike italiane, në fokus të veçantë në forcimin e rolit të lirive dhe të drejtave kushtetuese, cf. më shumë në shkrimin e gjerë të Paolo Passaglia, "Rights-Based Constitutional Review in Italy". Relazione svolta a *The Society of Legal Scholars Annual Seminar* 2013, svoltosi a Dublino il 2 e 3 luglio 2013. Në internet: http://www.giurcost.org/studi/Passaglia4.pdf.

[205] Paolo Passaglia, "The Italian system of constitutional Review: A Kelsenian model moving towards a decentralised model". Në John Bell, Marie – Luce Paris (eds.), *Rights Based Constitutional Review. Constitutional Courts in Changing Landscape* (Edward Elgar: UK & USA, 2016) fq. 247-275.

[206] Ibid., fq. 247-275.

[207] Tania Groppi and Irene Spingo, "The Constitutional Court of Italiy". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 516-559 në fq. 517.

tituzione in senso materiale (Giuffre: Milano, 1939).[208] Nën ndikimin e këtij autori, që nga fillimi ka mbizotëruar koncepti jo-formalistik dhe jo-dogmatik i kushtetutës dhe dispozitave të saj. Sipas tij, kuptimi i Kushtetutës tejkalon tekstin e shkruar për t'u bërë produkt i grupeve të ndryshme politike, shoqërore dhe ekonomike në kohë të ndryshme historike, po që në rrethana të tjera ato po ashtu mund të shërbejnë si mbështetës të tekstit të shkruar. Ky botëkuptim mbi Kushtetutën u shoqërua nga një interpretim krejt jo-pozitivist i saj nga ana **GJKIt**, që nga fillimi i punës, duke prodhuar interpretime kreative të tekstit të kushtetues.[209]

Sa i përket sistemit politik, **Kushtetuta e Italisë** (1948) është produkt i marrëveshjes së forcave të ndryshme politike, si **Demokracia Kristiane**, **Partia Komuniste**, një numër i partive të vogla të qendrës, e cila marrëveshje ngeli në gjysmë të rrugës si pasojë e fillimit të **Luftës së Ftohtë**. Akoma pa u miratuar Kushtetuta, marrëveshja u prish, gjë që pati dy lloje të pasojave: e para, shumë nga dispozitat e saj ngelën në letër dhe të pazbatueshme; dhe, e dyta, në mungesë të konsensusit, u arrit një marrëveshje e heshtur që amendamentimi i Kushtetutës mund të bëhet vetëm lidhur me disa ndryshime të vogla. Për amendamentimet e mëdha u la mundësia e rrugëve jo-formale. Kjo rrugë, në fakt, me kalimin e kohës u zhvillua, pikërisht si pasojë e këtij konteksti politik që ka shoqëruar zhvillimin e sistemit politik italian deri në ditët e sotme.[210]

Në rastin e **Kanadasë** vërehet ndikimi i madh i **Britanisë së Madhe** dhe kulturës juridike imperiale, siç vërehet edhe ndikimi i madh i praktikës gjyqësore të **Gjykatës Supreme të SHBA**-ve. Ndikimi amerikan ka ardhur në shprehje në veçanti pas vitit 1982, kur u nxor kushtetuta e parë e plotë e këtij vendi. Ky dallim në ndikim duhet parë në kontekstin kohor të zhvillimit historik të gjyqësisë kushtetuese në këtë vend. Deri në vitin 1982, **Kanada** nuk ka pasur një kushtetutë të shkruar: deri në këtë kohë ka vlejtur sistemi juridik dhe gjyqësor i Britanisë së Madhe, me **Privy Council** (**Këshillin Mbretëror i Drejtësisë**) me seli në **Londër**, si instancë e fundit për dhënien e drejtësisë në çështjet kushtetuese që kishin të bënin me **Kanadanë**. Kjo ka pasur për pasojë mbizotërimin e supremacisë (epërsisë) së të drejtës imperiale, njëjtë siç ka qenë rasti dikur me **SHBA**-të dhe kolonitë tjera britanike. Kjo ka nënkuptuar se edhe kultura juridike dhe etosi i interpretimit kushtetues kanadez është bazuar në përvojën britanike perandorake.

Kjo gjendje ka ndryshuar në vitin 1982, kur, siç u tha, u miratua **Kushtetuta e Kanadasë** që mishëronte edhe **Kartën për të Drejtat e Njeriut** (**Human Rights Charter**) Tani e tutje siguria e supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës u bë rend i ditës, duke lejuar krijimin e të drejtës nga gjyqësori përmes interpretimit teleologjik, ani se në Kartë ekziston një klauzolë që i jep të drejtë **Parlamentit të Kanadasë** për të kufizuar të drejtat kushtetuese të karakterit relativ të garantuara me te.[211] Ky kufizim mund të ndodhë vetëm për një kohë të caktuar deri në pesë vjet, pra ka karakter të përkohshëm. Vlen të theksohet se asnjëherë deri më sot, ky kufizim nuk është zbatuar në praktikë.[212]

Karta shërben aktualisht si një burim i rëndësishëm i së drejtës kushtetuese në këtë vend dhe si bazë e vendimmarrjes jashtëzakonisht liberale, duke lejuar gjyqtarët që të vendosin si leximin e ngushtë (**reading down**) ashtu edhe të gjerë (**reading in**) të tekstit kushtetues. Në fakt, **Gjykata Supreme e Kanadasë** (**GJSKa**) ka shërbyer si një interpretues shumë liberal i Kushtetutës, duke u mbështetur në

---

208 Cf. më shumë për këtë dhe kontekstin historik të ideve të C. Mortati dhe konceptit të tij mbi kushtetutën reale në Jörg Luther, "Realism and Idealism in the Italian Constitutional Culture". Në Maurice Adams, Anne Meuwese, Ernst Hirsch Ballin (eds.), *Constitutionalism and the Rule of law. Bridging Idealism and Realism* (Cambridge University Press: Cambridge, 2017) fq. 326-357.

209 Tania Groppi and Irene Spingo, "The Constitutional Court of Italiy". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 518.

210 Ibid., fq. 518.

211 Sanjeev Anand, "The Truth About Canadian Judicial Activism" *Constitutional Forum* Vol. 15 No. 2 (2006) fq. 87-98 në fq. 87-89.

212 Cf. më shumë për historikun e zhvillimit të kulturës së interpretimit kushtetues në Kanada, para dhe pas nxjerrjes së Kushtetutës së vitit 1982, në Carl Baar, "Judicial Activism in Canada". Në Keneth M. Hollan (ed.), *Judicial Activism in Comparative Perspective,* fq. 53-69.

përvojën amerikane. Në vendimmarrjen e saj, ajo ka bërë të qartë se Kushtetuta është një dokument i gjallë, evolutiv dhe se vetë ajo e ka për detyrim që ta marrë parasysh jo vetëm tekstin, por kryesisht dhe mbi të gjitha qëllimin dhe objektin e saj marrë si tërësi.

Në këtë kuptim, në praktikën e **GJSKa**, leximi i ngushtë (**reading down**) ushtrohet në atë mënyrë që teksti i normës juridike me një kuptim të gjerë lexohet ngushtësisht me qëllim të sjelljes së tekstit në harmoni me dispozitën kushtetuese. Kështu, ta zëmë, në një urdhër komunal që ndalonte vënien e shenjave zgjedhore në pronën private, leximi ka qenë i ngushtë ashtu që ka përjashtuar zgjedhjet federale, gjë që ka nënkuptuar se në zgjedhjet e llojit të fundit (zgjedhjet federale) nuk mund të vlente një kufizim i tillë komunal.[213] Në mënyrë të njëjtë me këtë, por me kuptim të kundërt, leximi i gjerë (**reading in**) nënkupton që krejt elementet jokushtetuese të një teksti ligjor që duhet të zbatohet, largohen (hiqen) nga norma e sfiduar dhe nuk lexohen. Kështu, ta zëmë, në një tekst ligjor ka munguar fjalia "orientimi seksual" si bazë për diskriminim ashtu që **GJSKa** e ka lexuar tekstin në atë mënyrë që ka futur edhe fjalinë "orientimi seksual" si njëra ndër bazat për diskriminim, krahas etnicitetit, gjuhës, prejardhjes sociale dhe tjetër, dhe kështu me radhë.[214]

Një cilësi tjetër e praktikës së **GJSKa** është edhe **mendimi këshillëdhënës** që ajo mund ta jap sipas kërkesës së ekzekutivit. Praktika e dhënies së mendimeve këshillëdhënëse shërben si një bazë shtesë për aktivizëm gjyqësor, përkundër faktit që, siç u tha, vetëm gjyqtarët dhe komuniteti juridik pranojnë dhe inkurajojnë një interpretim liberal të tekstit të Kushtetutës, që bazohet në qëllimin dhe objektin e saj, jo në tekstin e shkruar. Kjo nuk ka qenë kështu para vitit 1982: para nxjerrjes së Kushtetutës, gjyqtarët nuk kanë qenë aq fleksibël. Në fakt, ata kanë qenë të rezervuar dhe me shumë dilema, në veçanti sa i përket lirive dhe të drejtave të njeriut, të cilat sot nuk shihen si diçka të dhëna nga natyra por nga Kushtetuta, e cila konsiderohet gjerësisht si një produkt evolutiv i historisë, vlerave, kulturave dhe filozofive shoqërore të Kanadasë.

Nuk bën përjashtim këtu as sfera e kontrollit abstrakt të normës juridike, si dhe vendimmarrja e **GJSKa** në sferën e konfliktit për kompetencë dhe ndërhyrjet tjera në ushtrimin e pushtetit në këtë vend, ku qasja liberale e interpretimit vihet në spikamë.[215]

Në rastin e **Britanisë së Madhe**, konteksti kulturor kushtetues është jashtëzakonisht specifik, siç është i tillë edhe në ato vende që modelohen sipas sistemit të saj kushtetues, përkundër faktit se shumica prej tyre kanë miratuar kushtetuta të shkruara duke ruajtur, në të njëjtën kohë, të **drejtën e përgjithshme** si burim primar të së drejtës. Siç e kemi vënë në dukje gjetiu, vetë kontrolli gjyqësor ka lindur në Angli në rastin **Dr. Bonham**, pa u zhvilluar tutje në kontroll gjyqësor të kushtetutshmërisë. Kjo ka ndodhur si pasojë e zhvillimit historik të kulturës kushtetuese britanike. Kjo kulturë nuk ka hierarki të normave juridike: normat juridike me karakter kushtetues në këtë vend kanë fuqi të njëjtë si normat juridike ligjore dhe normat tjera të karakterit të përgjithshëm. Ky fakt ka penguar dhe pengon kontrollin gjyqësor të kushtetutshmërisë, i cili ka lindur dhe asocohet në rend të parë dhe mbi të gjitha me sigurimin e supremacisë (epërsisë) së normave kushtetuese kundrejt atyre që nuk kanë karakter të tillë. Në vijim të sigurimit të kësaj supremacie (epërsie) ka lindur edhe aktivizmi gjyqësor në gjyqësinë kushtetuese. Pa këtë rrethanë nuk do të kishte pasur mundësi të lind aktivizmi gjyqësor. Kjo vetvetiu shpjegon natyrën specifike të kulturës juridiko-kushtetuese në Britani: historia e saj ngushtësisht lidhet me ngjarjet e mesit të shekullit 17-të dhe luftën në mes të monarkut dhe parlamentit britanik, luftë që ka rezultuar me fitoren e këtij të fundit dhe sanksionimin juridik të saj, e njohur ndryshe si supremacia (epërsisë) parlamentit. Këtë sanksionim juridik e ka reflektuar **Instrumenti i Qeverisjes** (1653).

---

213 Hugo Cyr and Monica Popescu, "The Supreme Court of Canada". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 163 fusnota 49 dhe teksti që e shoqëron.

214 Ibid., fq. 163-164, fusnota 50 aty, si dhe teksti që e shoqëron.

215 Ibid., fq. 154-198, në fq. 154-167.

Që nga kjo kohë e deri në ditët e sotme, zhvillimi kushtetues i **Britanisë së Madhe** ka qenë evolutiv. Asnjëherë deri në vitin 1972, ky vend nuk e ka njohur të drejtën e gjyqësorit për të vlerësuar cilësinë e ligjeve, me kuptim vlerësimin e fuqisë së tyre juridike kundrejt normave të tjera kushtetuese. Kjo kulturë kushtetuese ka ndryshuar në këtë vit, kur nis ndryshimi për shkak të ratifikimit të marrëveshjeve për hyrje në **Bashkimin Ekonomik Evropian** (**BEE**), tani **BE**, duke e pranuar (njohur) supremacinë (epërsinë) e marrëveshjeve për aderim në **BE** kundrejt normave të tjera juridike. Për herë të parë një akt jashtë parlamentar fiton një cilësi sipërore kundrejt akteve juridike të parlamentit: çdo normë juridike tani e tutje duhej të ishte në harmoni me **Ligjin e Britanisë për BEE.**[216] Për pasojë, që nga kjo kohë, gjyqtarët britanik kanë pasur për detyrë që të mënjanojnë dhe mos të zbatojnë ligjet dhe normat tjera të nxjerra nga parlamenti britanik në rastet kur ato binin ndesh me të drejtën evropiane. Me nisjen e procedurës së **BREXIT**-it, kjo gjendje ka nisur të ndryshojë dhe tani pas daljes nga BE, ka ardhur deri te rikthimi i supremacisë (epërsisë) absolute të akteve të parlamentit britanik.

Një moment tjetër me rëndësi, i cili ka sfiduar supremacinë (epërsinë) e akteve të parlamentit, ka ndodhur në vitin 1988: në këtë vit, **Britania e Madhe** ka internalizuar **KEDNJ**, duke ua njohur gjyqtarëve të drejtën për të zbatuar në mënyrë të drejtpërdrejtë standardet e mishëruara në dispozitat e saj. Në rast të mospërputhjes së ligjeve britanike me standardet e vëna nga **KEDNJ**, gjyqtarët britanik u autorizuan që të interpretojnë ligjet në fjalë sa më shumë që të jetë e mundur në pajtim me **KEDNJ**. Në të kundërtën, pra kur bëhet fjalë për kolizion në mes tyre, përkatësisht në rastet kur ligjet britanike bien ndesh më **KEDNJ**, gjyqtarët kanë për detyrë të lëshojnë të a.q. **deklaratë të mospërputhshmërisë** në mes të normës britanike dhe standardit të **KEDNJ**. Kjo nënkupton, në të njëjtën kohë, që gjyqtarët britanik nuk kanë të drejtën për të mënjanuar (moszbatuar) ligjet vendore, por vetëm për të dhënë deklaratën si më sipër për mospërputhshmëri, e cila ka efekt ekskluzivisht deklarativ, duke ia lënë parlamentit mundësinë për të mënjanuar mospërputhshmërinë e tillë në mes të aktit të vet dhe **KEDNJ.**[217] Procedurat e **BREXI**-t nuk kanë ndikim në këtë status juridik të standardeve të vëna nga KEDNJ, as pas realizimit të tij me sukses të daljes së Britanisë nga BE. E thënë me fjalë të tjera, standardet e **KEDNJ** kanë një jetë autonome dhe nuk varen nga fluktuimet politike evropiane por nga dinamikat e përgjithshme evropiane në sferën e promovimit dhe mbrojtjes efektive të lirive dhe të drejtave të njeriut sipas standardeve të vëna nga Gjykata e Strasburgut. Në këtë kuptim, Britania e Madhe nuk dallon asgjë nga sistemet tjera kushtetuese të vendeve anëtare të KE (dhe, për pasojë, të KEDNJ). I vetmi dallim është në teknikën juridike me të cilën Britania ka internalizuar dispozitat e KEDNJ në sistemin e saj kushtetuese. Sikundër dihet, sistemi britanik dallon dukshëm nga vendet tjera. Në këtë vend, për t'u bërë pjesë e sistemit të brendshëm një marrëveshje ndërkombëtare, ajo duhet të inkorporohet në tërësi në ligjin e brendshëm të parlamentit britanik, me të njëjtin emër. Nëse ky nuk është rasti, pra nëse ligji britanik nuk përmban në mënyrë shprehimore dispozitat e KEDNJ, apo të ndonjë marrëveshje apo akti tjetër ndërkombëtar, atëherë nuk konsiderohet se është bërë pjesë e sistemit kushtetues britanik. Kjo nuk do të thotë se marrëveshja e lidhur, apo akti tjetër ndërkombëtar i miratuar nga organet kompetente britanike për politikën e jashtme nuk përbën një detyrim ndërkombëtar. Përkundrazi, ai paraqet një detyrim ndërkombëtar dhe për te vlejnë rregullat e të drejtës ndërkombëtare kontraktuale. Për t'u bërë pjesë e sistemit të brendshëm britanik, megjithatë, marrëveshja apo akti tjetër juridik i lidhur apo miratuar nga organet kompetente për politikë të jashtme duhet të internalizohet në mënyrë të qartë me një akt të brendshëm, kryesisht ligj, ku në mënyrë të qartë pranohen në rendin e brendshëm dispozitat e tyre. Aktet e parlamentit zakonisht kanë emrin e aktit apo

---

[216] Në rastin e njohur *R v Secretary of State for Transport, exp Factortame Ltd*, Dhoma e Lordëve vendosi që gjykatat në **Britaninë e Madhe** kanë autorizime për moszbatim të akteve të parlamentit kur ato bien në kundërshtim me të drejtën e BE-së. Me këtë rast, **Lord Bridge** mbajti qëndrim se Parlamenti në mënyrë vullnetare ka pranuar këtë kufizim të sovranitetit të vet, duke qenë tërësisht i vetëdijshëm se, përkundër faktit që kufizimi i sovranitetit nuk përfshihet shprehimisht në **Traktatin e Romës**, si i tillë ka qenë i pranuar në praktikën gjyqësore britanike edhe para se Parlamenti të nxjerr **Ligjin mbi BEE**-në në vitin 1972. Cf. Paul Craig and Gráinne de Búrca (eds.), *EU law.Text, Cases, and Materials*. Fourth Edition (Oxford University Press: Oxford, 2007) fq. 367-368.

[217] Colm O'Cinneide, *Human rights and the UK constitution September* (The British Academy: London, 2012), Chapter 2 (The current system of human rights protection 13 in the UK", 13 – 25) & Chapter 3 ("The Relationship Between UK and the ECHR", fq. 26-36).

marrëveshjes ndërkombëtare. I tillë është rasti edhe me KEDNJ, kur akti që internalizon këtë konventë në sistemin britanik quhet **Human Rights Act** apo **Ligjit mbi të Drejtat e Njeriut**. Kjo nuk është kështu në Kosovë dhe në shumicën e vendeve evropiane, ku instrumenti ligjor që ratifikon një marrëveshje apo akt tjetër ndërkombëtar nuk ka asnjë vlerë (fuqi) normative. Ai shërben vetëm si një teknikë juridike për futjen në sistemin e brendshëm juridik, kurse fuqi zbatuese kanë vetëm dispozitat e marrëveshjes apo aktit tjetër juridik që ratifikohet me ligj. Nëse marrëveshjet apo aktet ndërkombëtare që ratifikohen kanë dispozita të vetekzeuteshme, atëherë zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në të kundërtën duhet sërish një legjislacion shtesë (apo nxjerrja e akteve të tjera juridike shtesë), për t'i operacionalizuar dhe bërë të zbatueshme.

T'i kthehemi sërish rastit britanik edhe për disa momente.

Krahas dy këtyre autorizimeve si më sipër në favor të gjyqtarëve britanikë, ekziston edhe një sferë e tretë në të cilën këta gjyqtarë kanë autorizime për të vendosur rreth cilësisë së ligjeve të parlamentit. Kjo ka të bëjë me ligjet që normojnë situatat e a.q. të bartjes së pushtetit (**power devolution**), të rregulluara me ligjet e parlamentit të vitit 1998. Këto ligje njihen ndryshe si ligjet për bartjen e pushtetit (**power devolution laws**).[218] Këto janë ligje që i nxjerr parlamenti britanik për bartjen graduale të shumë autorizimeve ligjvënëse, ekzekutive dhe administrative në **Skotlandë**, **Uells** dhe **Irlandën e Veriut**. Për kontrollin e cilësisë së këtyre ligjeve me rastin e vënies së tyre në jetë janë kompetent gjyqtarët e **Gjykatës Supreme të Britanisë së Madhe (GJSBM)**, e cila ka zëvendësuar funksionet gjyqësore të Dhomës së Lordëve. Kjo nuk do të thotë se parlamenti britanik ka humbur supremacinë (epërsinë): ky organ akoma ruan këtë epërsi (supremaci) në tërë territorin britanik, përveç çështjeve që janë bartur në tri entitetet si më sipër. Për dallim nga ligjet e **Westminster**-it, të cilat nuk mund të sfidohen nga gjyqësori britanik në asnjë pjesë të territorit nacional, ligjet e tri njësive si më sipër mund të sfidohen nga instanca më e lartë e gjyqësorit britanik – **GJSBM.** Ky organ vendos për pajtueshmërinë e ligjeve me të cilat është bartur pushteti në kuptimin si më sipër me ligjet e miratuara nga **Westminster**-i.[219]

Pyetjet që shtrohen, atëherë, janë këto: pse kjo kulturë juridike në **Britani të Madhe**? Cila ka qenë mënyra e interpretimit e gjyqtarëve britanik të teksteve ligjore dhe akteve të tjera **parlamentit britanik**?

Siç dihet, Britania nuk ka një kushtetutë të shkruar. Atje ekzistojnë norma të rëndësisë kushtetuese, por që nuk kanë një hierarki që bazohet në fuqinë e tyre juridike. Kjo cilësohet si kushtetutë materiale apo substanciale, ani se në literaturë flitet edhe për kushtetutë politike britanike.[220] Sido që të jetë, ky vend ka rregulla juridike që normojnë materien kushtetuese që kanë të bëjnë me organizimin dhe formën e pushtetit dhe me rolin dhe pozitën e individit në shoqëri. Aktet juridike jashtë parlamentit britanik, të cekura më sipër, përfshirë aktet juridike që rregullojnë pushtetet e bartura në **Skotlandë**, **Uells** dhe **Irlandë të Veriut**, kanë dhënë shkas që në literaturë të flitet për **Kushtetutën e re Britanike.**[221] Kjo për faktin se ekzistojnë norma juridike me karakter kushtetues që nuk nxirren nga parlamenti britanik. Ky aktivitet normativ jashtë parlamentit e bën legjitim edhe pyetjen lidhur me llojin e interpretimit në këtë vend: para vitit 1972, në literaturë është vërejtur se interpretimet juridike kanë qenë shumë **formaliste**, në ndërkohë që kjo ka ndryshuar me ndryshimin e aktivitetit legjislativ të strukturave jashtë parlamentit, përkatësisht me ligjvënien britanike që është ndikuar nga faktorët jashtë-parlamentar (si p.sh ratifikimi i dokumenteve që kanë të bëjnë me **BE** dhe supremacinë e normave evropiane, me internalizimin e standardeve të **KEDNJ** në sistemin juridik britanik dhe kështu me radhë). Ky ndryshim në shkaqet e ligjvënies në Britani ka shkaktuar ndryshime në teknikën e interpretimit: ka qenë krejt e arsyeshme që gjyqtarët britanik më nuk mund të mbështeten ekskluzivisht në tekstin juridik por në kontekstin e lindjes dhe interpretimit të tij.

---

218 Tamas Gyorfi, "The Supreme Court (House of Lords) of the United Kingdom." Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 679-722 në fq. 685.

219 Peter Leyland, "The multifaceted constitutional dynamics of U.K. devolution*". International Journal of Constitutional law* Vol. 9 No. 1 (2011) fq. 251–273 në fq. 268-271.

220 Tamas Gyorfi, "The Supreme Court (House of Lords) of the United Kingdom", fq. 683.

221 Ibid., fq. 685.

Kjo nënkupton se, aktualisht, interpretimi britanik është **teleologjik** ashtu që gjyqtarët duhet të marrin parasysh jo vetëm kontekstin historik të lindjes së normës në parlamentin e Britanisë por, mbi të gjitha, vetë objektin dhe qëllimin e akteve të përgjithshme juridike të cilat ky vend i ka ratifikuar dhe i ka bërë pjesë të sistemit të brendshëm juridik përmes aktivitetit ligjvënës.[222]

Krejt kjo që u tha më sipër, i referohet normave të shkruara kushtetuese dhe interpretimit të tyre, në ndërkohë që sa i përket interpretimit të **drejtës së përgjithshme** dhe **precedentëve gjyqësorë** si burime të së drejtës vlejnë rregulla tjera të interpretimit, që diktohen nga një kulturë juridike shekullore britanike. Këtu nuk mund të vlejnë standardet që vlejnë për interpretimin e teksteve të shkruara dhe të burimeve të tjera formale të së drejtës. Në këto raste nuk bëhet fjalë për aktivizëm gjyqësor, në kuptim të aktivitetit të normëvënies gjyqësore, sepse një gjë e tillë përbën vetë esencën e sistemit britanik të precedenteve. Nisur nga kjo, nëse mund të bëhet fjalë për aktivizëm gjyqësor në sferën e precedenteve, atëherë mund të thuhet se ai ekziston vetëm atëherë kur ka devijim të paarsyeshëm nga precedenti i mëhershëm apo kur ai ndryshon me arsyetim legjitim por mbi bazën e rrethanave të reja të ndryshuara.

Një rast tjetër mjaft interesant dhe që ngjason me **Gjermaninë** dhe **Italinë** në aspektin e kulturës juridike dhe kushtetuese paraqet rasti **Spanjës**. Nxjerrja e Kushtetutës së vitit 1978, pas dyzetë vjet të diktaturës së gjeneralit **Franko**, ka shënuar ndërprerjen radikale me të kaluarën dhe ka reflektuar synimet spanjolle për të ecur përpara si një shoqëri liberale, duke lënë prapa historinë e kaluar tragjike. Dizjani kushtetuese spanjoll, me një fjalë, ngërthen në vetvete elemente të projektit transformues dhe aspirues: Kushtetuta ka qenë, në të njëjtën kohë, produkt i tranzicionit dhe vetë instrument i tij. Tranzicioni spanjoll është kryer thuajse në mënyrë konsensuale.[223] Kjo perspektivë kushtetuese, tërësisht me orientim liberal, është parë edhe në rastet e **Austrisë, Gjermanisë**, **Italisë** dhe në secilin vend tjetër që ka mëtuar të ridefinohet përgjatë vijave të konstitucionalizmit modern liberal perëndimor (siç ka qenë rast, ta zëmë, me vendet ish-komuniste pas vit të 1990).[224] Në këtë drejtim, as **Kosova** nuk përbën një përjashtim.

Kultura juridike dhe konteksti historik spanjoll është reflektuar në secilën pjesë të Kushtetutës. Kjo kulturë juridike dhe ky kontekst historik më së shumti ka ardhur në shprehje në sferën e sanksionimit të lirive dhe të drejtave kushtetuese dhe në sferën e krijimit të mekanizmit të gjyqësisë së ndarë kushtetuese të tipit **evropian/kelsenian**. Në rastin e lirive dhe të drejtave të njeriut, Kushtetuta iu dha atyre një vend të posaçëm duke i bërë dispozitat me karakter dhe fuqi normative. Kjo përbënte diçka të re dhe nuk qe pranuar lehtë nga gjyqtarët dhe komuniteti juridik i **Spanjës**, të cilët ishin edukuar në sistemin e gjeneralit **Franko.**[225] Kjo edhe më shumë erdhi në shprehje te roli dhe pozita e **Gjykatës Kushtetuese të Spanjës** (**GJKSp**), rreth themelimit të së cilës kishte pasur një konsensus të plotë, por jo për arsye teorike. **Spanja** ka pasur një gjyqësi embrionike kushtetuese dhe një gjykatë kushtetuese, e njohur si **Gjykata e Garan-**

---

222 Ibid., fq. 686-687.

223 Geoffrey Brennan and Jose Casas Pardo, A Reading of the Spanish Constitution (1978) . *Constitutional Political Economy* Vol. 2 No. 1 (1991) fq. 53-79 në fq. 56, 59, 77-78 (autori thekson, megjithatë, se Kushtetuta e vitit 1978 nuk ka pasur një përkrahje të madhe popullore: përkrahja e saj ka qenë relativisht e moderuar, por kjo nuk çon peshë sepse procesi i kushtetutëbërjes si i tillë ka qenë thuajse konsensual në mes të akterëve kryesorë vendimmarrës të kohës).

224 Për një analizë të shkëlqyer të dizajneve kushtetuese të vendeve post-revolucionare, të rolit të kufizimeve të ndryshme në kohë dhe hapësirë, të rolit të motivimeve indivduale (dëshirave dhe bindjeve), si dhe të përmbledhjes, transformimit dhe keqinterpretimit të preferencave të shoqërisë që synon nxjerrjen e kushtetutës si një përpjekje kolektive, Cf. më shumë në Jon Elster, "Forces and Mechanisms in the Constitution - Making Process" *Duke law Journal* Vol. 45 Issue 2 (November 1995) fq. 364-396 (ku autori diskuton dizajnet kushtetuese nga këndet si më sipër në tetë valët e kushtetutëbërjes, që fillojnë nga viti 1780 deri në rënien e komunizmit; e përbashkët është se rrethanat post-revolucionare e vënë në spikamë më shumë aspektin transformues dhe prospektiv se në situatat e kushtetutbërjes në rrethana evolutive; në këtë grup hyn edhe rasti i kushtetutbërëjes në **Spanjë**, të cilën autori e diskuton në secilin segment të saj, si p.sh: kufizimet objektive gjatë procesit të kushtetutëbërëjes, preferencat individuale të gjeneratës së nxjerrjes së kushtetutës së vitit 1978 si dhe konsensusi thuajse maksimal i politikanëve të kohës dhe mbretit spanjoll sa i përket rolit neutral të ushtrisë spanjolle, njohja e komuniteteve autonome dhe pasiviteti i **Kishës Katolike** në jetën publike).

225 Për më tepër, në literaturë thuhet se kushtetutëbërësit spanjoll ka bërë një sforcim jo me vend dhe në mënyrë të tepruar të rolit dhe pozitës së dispozitave kushtetuese mbi liritë dhe të drejtat e njeriut në sistemin e ri kushtetues post-diktatorial. Cf. Geoffrey Brennan and Jose Casas Pardo, A Reading of the Spanish Constitution (1978), fq. 62.

cioneve Kushtetuese, që ka ekzistuar në periudhën 1933-1939. Kjo rrethanë ka qëndruar fuqishëm si një hije motivimi për idenë e rikrijimit të një institucioni të ndarë të gjyqësisë kushtetuese.[226]

Krahas kësaj kulture juridike, konteksti historik po ashtu ka luajtur një rol kolosal: përvojat e **Gjermanisë** dhe **Italisë** në këtë drejtim kanë qenë vendimtare, sepse suksese i gjykatave kushtetuese në këto dy vende rrezatonte motivacion të fortë për përdorimin e një gjykate të ndarë kushtetuese si mjet transformues të shoqërisë spanjolle dhe integrimin e saj në **Evropë** pas diktaturës së gjatë frankiste.[227]

Roli primar i **GJKSp**, në vijim të manifestimit të kulturës juridike të kohës, ka qenë udhëheqja e gjyqësorit të rregullt në drejtim të shkatërrimit të legjislacionit antikushtetues që ishte nxjerrë në kohën e **Frankos.**[228] Kjo, në të njëjtën kohë, nënkuptonte që ajo duhej të ndërtonte standardet e reja të interpretimit të tekstit ligjor në mënyrë që ai të ishte në harmoni me normat, parimet dhe vlerat e Kushtetutës. **GJKSp**, që në fillim e ka bërë një gjë të tillë me shumë trimëri dhe kompetencë, duke ia bërë me dije gjyqësorit të rregullt se Kushtetuta ishte tekst normativ me fuqi më të madhe juridike se çdo akt tjetër juridik në vend. Për të bërë këtë, ajo është angazhuar për një interpretim që definon konceptet bazë kushtetuese dhe ndërton doktrinë të re, si në sferën e organizmit dhe ndarjes së pushteteve ashtu edhe në lëmin e lirive dhe të drejtave të njeriut. Krejt kjo u bë në një vakum sepse në **Spanjë** nuk kishte pasur një traditë kushtetuese sa i përket kushtetutshmërisë. Kjo nga shkaku se, siç u tha, komuniteti juridik i gjyqtarëve dominohej nga dogmatikët fanatikë të diktatorit **Franko.**[229] Kjo shpjegon edhe faktin që në përbërjen e parë të saj, nga 12 anëtar të saj, 9 kanë qenë profesor eminent të universitetit.[230]

Në **Spanjë**, megjithatë, ka ekzistuar një traditë e gjatë e interpretimit jo-dogmatik para ardhjes së Frankos në pushtet. Kjo shihet qartë nga dispozitat e **Kodit Civil Spanjoll** të shekullit 19-të, që stimulonte metodën interpretuese të juristit gjerman **Savigny** (**Friedrich Carl von Savigny**: 1779-1861), me një përjashtim që nuk parashikonte interpretimin teleologjik dhe evolutiv (sociologjik). Në aspektet tjera, kultura juridike spanjolle e interpretimit kishte për bazë tekstin, kontekstin (aktual dhe të kohës së nxjerrjes së tekstit), si dhe vetë shpirtin dhe qëllimin e normës. Kjo pati pasojë pozitive në punën e **GJKSp**, në veçanti në vitet e para formative të saj. Jo rrallë, ky organ ka përdorur edhe argument **ekstra-kushtetuese** për arsyetimin e vendimeve të saj, si nga përvoja e gjykatave tjera ashtu edhe nga tekstet e autorëve të ndryshëm spanjoll dhe të huaj. Vend të posaçëm kanë zënë doktrinat gjermane të gjyqësisë kushtetuese, si p.sh. doktrina e proporcionalitetit, doktrina e unitetit të kushtetutës si një tërësi e rregullave juridike normative, doktrina e konkordancës praktike etj. etj.

Roli i jashtëzakonshëm i **GJKSp** bie në sy në veçanti në vitet e para formative. Këtu një rol të madh kanë pasur vendimet mbi **ankesat kushtetuese** (**amparo**), ku ajo ka bërë lidhshmërinë në mes të lirive dhe të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe instrumenteve ndërkombëtare mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, si dhe rëndësinë që ka për vendin jurisprudenca e **GJEDNJ.**[231] Përvoja spanjolle me ankesën kushtetuese (**amparo**) bazohet në traditën gjermane të ankesës kushtetuese (**Verfassungsbeschwerde**), më shumë se në shembullin **meksikan** të shekullit XIX, i cili më vonë është përhapur në shumë vende të tjera të **Amerikës Latine.**[232]

---

226 Marian Ahumada Ruiz, "The Spanish Constitutional Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 604-640 në fq. 606.

227 Ibid., fq. 604.

228 Enrique Guillen Lopez, "Judicial Review in Spain: The Constitutional Court" *Loyola of Los Angeles law Review* Vol. 41 Issue 2/3 (2008) fq. 259-262 në fq. 542.

229 Ibid., 532, 541.

230 Marian Ahumada Ruiz, "The Spanish Constitutional Court", fq. 606.

231 Ibid., fq. 618.

232 **Amparo** meksikane dhe ne vendet tjera të **Amerikës Latine** ka një përmbajtje tjetër dhe paraqitet në disa forma dhe lloje, me shumë dallime në krahasim më ankesën kushtetuese spanjolle, e cila, siç u tha, në tërësi modelohet sipas përvojës gjermane dhe është ndikuar nga rastin gjerman. Cf. më shumë për këtë në Hector Fix Zamudio, "The Writ of Amparo in Latin America" . *University of Miami Inter-Americal law Review* Vol. 13 Issue 3 (1981) fq. 361-391.

T'i kthehemi tani **Kosovës** dhe dy rasteve më të përfolura kuluareve për gjoja ushtrim të aktivizmit gjyqësor nga ana e **Gjykatës Kushtetuese**.

Ajo që zakonisht është cilësuar si aktivizëm gjyqësor në diskursin publik kosovar, kryesisht është bërë nga të a.q. **ekspertë kushtetues** dhe i referohet dy rasteve: i pari rast është rrëzimi i **Behxhet Pacollit** nga posti i **Presidentit të Kosovës**, pozitë që ai e ka mbajtur deri në vendimin e Gjykatës me të cilin u konstatua se një mbajtje e tillë kishte qenë kushtetuese, por jo edhe vendimi për zgjedhjen e tij për President nga ana e Kuvendit të Kosovës; dhe, i dyti, ngjashëm me këtë, rasti lidhur me vendimin për gjoja **heqjen e imunitetit të deputetëve** nga ana e Gjykatës.

Në këto dy raste ka ardhur në shprehje ndikimi i kulturës juridike dhe kushtetuese nga e kaluara: në të kaluarën komuniste të vendit, nuk ka ekzistuar asnjë mundësi që dikush të ketë trajnim apo edukim juridik mbi juridiksionin e gjykatave kushtetuese që përfshinë të drejtën e tyre për mbikëqyrje të zgjedhjes së shefit të shtetit dhe anulim të kësaj zgjedhje në rastet kur cilësohet si zgjedhje jo legjitime në asketin kushtetues. E njëjta vlen, **mutatis mutandis,** edhe për juridiksionin e gjykatave kushtetuese në sferën e kontrollit kushtetues të jetës dhe punës së partive politike, juridiksionin lidhur me caqet dhe natyrën e imunitetit funksional si kategori kushtetuese dhe si standard i ri në disa vende ish-komuniste (në komunizëm ka ekzistuar imunitetit absolut i kategorive të caktuara të funksionarëve shtetëror), si dhe për shumë aspekte juridiksionale të këtyre gjykatave.

Rasti Pacolli, tanimë i diskutuar në këtë kapitull,[233] ka qenë i qartë në aspektin profesional sepse zgjedhja e B. Pacollit për President të Kosovës ka qenë i shoqëruar me shkelje kushtetuese nga ana e Kuvendit të Kosovës, përkatësisht me shkelje të procedurave standarde për zgjedhjen përmes tri raundeve me më shumë së një kandidat. Nuk do shumë mend për të kuptuar se vetë fjala zgjedhje nënkupton vendosje në mes të dy opsioneve apo situatave në një procedurë publike dhe transparente, krejtësisht të barabartë për të gjithë ata që synojnë postin publik që i nënshtrohet zgjedhjes.

E njëjta vlen edhe për **rastin e Imuniteteve**, të deputetëve dhe krejt funksionarëve të lartë shtetëror në Kosovë. Nuk ka asnjë dyshim se imuniteti i dhënë një funksionari shtetëror paraqet një variant të privilegjeve që norma kushtetuese e njeh në favor të disa individëve me qëllim të ushtrimit sa më të lehtë dhe pa asnjë pengesë të funksionit të tyre. Në fakt, vetë ideja e lindjes së imuniteteve ka të bëjë më këtë, me kryerjen si duhet dhe pa pengesa e frikë të detyrës së marrë sipas kushtetutës e ligjit. Edhe imuniteti diplomatik e ka këtë mesazh: ai është absolut për nga natyra kundrejt shtetit pritës, por në origjinë dhe përmbajtje është funksional, gjë që shprehimisht thuhet në konventat ndërkombëtare që normojnë imunitetin dhe privilegjet diplomatike të të gjitha llojeve dhe rasteve (ambasadorë, misione të specializuara, misione **ad hoc**, misione pranë organizatave ndërkombëtare dhe kështu me radhë). Në të vërtetë, imuniteti diplomatik garantohet me normat **jus cogens** të së drejtës ndërkombëtare zakonore. Këtë qasje dhe këtë gjendje të gjërave dhe të literaturës juridiko-kushtetuese komparative dhe juridiko-ndërkombëtare e ka pasur parasysh **Gjykata Kushtetuese** kur ka vendosur për **rastin e Imuniteteve**.

Diskursi laik, që ia ka veshur Gjykatës Kushtetuese epitetin e një gjykate aktiviste duke u bazuar në komentimin jo-profesional dhe të bazuar në klishetë me prejardhje të kulturave juridiko-kushtetuese ish-komuniste, nuk ka gjetur asnjë përkrahje në qarqet profesionale ndërkombëtare, por as ndër monitoruesit e punës së kësaj Gjykate. E kemi fjalën për monitorues të proveniencës ndërkombëtare. E njëjta vlen edhe për rastet tjera të shprehura aty-këtu gjatë viteve të para të punës së **GJKRKS**, kohë gjatë së cilës në krye të saj ka qenë autori i parë i këtij libri (2009-2015). Këtë do ta ketë lexuesi edhe më të qartë kur të diskutohen vendimet e Gjykatës në dhjetëvjetorin e parë të saj, që pason në kapitullin e gjashtëmbëdhjetë, ku përfshihen edhe dy vendimet si më sipër (rasti Pacolli dhe rasti i Imuniteteve).

Se ky diskurs nuk ka pasur mbështetje të qarqeve profesionale dhe të tjera në arenën ndërkombëtare është reflektuar në raportin e **Freedom House** për vitin 2012, ku në mënyrë të qartë lavdërohet puna e

[233] Cf. më shumë në fus. 28, 121-123, **supra**, dhe teksti që i shoqëron.

Gjykatës, duke e cilësuar vendimet për rastin **Pacolli** dhe **imunitetet e funksionarëve të lartë shtetëror të Kosovës**, por edhe vendimet tjera, si vendime gurthemel të gjyqësisë kushtetuese kosovare. Për më tepër, këta monitorues qartë e kanë bërë me dije në raportet e tyre se Gjykata Kushtetuese ka qenë i vetmi institucion jashtë ndikimit të pushtetit, diçka që nuk është thënë asnjëherë për gjyqësorin e rregullt dhe për organet tjera të drejtësisë kosovare të kohës së raportimit.[234]

14.7. Komente dhe pyetje

14.7.1. Fenomeni i **aktivizmit gjyqësor**, si çdo fenomen që ka rrënjë në forca shoqërore të llojit të caktuar, mund të mendohet se ka pasur pararendës teorik dhe filozofik, për t'u bartur në terrenin e praktikës gjyqësore. Kjo, megjithatë, nuk është kështu: ky fenomen ka lindur jashtë ndonjë konteksti teorik dhe filozofik. Shpjegoni arsyet pse kjo është kështu!

14.7.2. Sidoqoftë, aktivizmit gjyqësor i kanë pararendur disa diskutime teorike që ne sot i konsiderojmë si një kuadër ku mund të ketë qëndruar ideja fillestare për lindjen e fenomenit në fjalë. Ai diskutim lidhet me idetë e një autori amerikan dhe është cilësuar si realizëm legal. Çfarë do të thotë **realizmi legal** dhe cila është baza kryesore arsyetimit të tij?

14.7.3. Fenomeni i **aktivizmit gjyqësor**, në literaturë zakonisht asocohet me togfjalëshin **ligjvënës negativ vs ligjvënës pozitiv**. Më pastaj, nën këtë term janë futur edhe përbërës të tjerë. Në kohën e sotme, nocioni **aktivizëm gjyqësor**, përndryshe mjaft i përbuzur në diskursin publik, ngërthen në vete element përbërës mjaft të ndryshëm dhe më të strukturuar se koncepti që shprehet në togfjalëshin **ligjvënës negativ vs ligjvënës pozitiv**. Para se të kuptohen elementet përbërëse të aktivizmit gjyqësor duhet të dihet dallimi në mes të cilësorit **aktiv** te togfjalëshi **gjyqësor aktiv** dhe emrit foljor **aktivizim** te togfjalëshi **aktivizim gjyqësor**, të cilët në shikim të parë mund të ngatërrohen dhe të duken sikur kanë të njëjtin kuptim. Diskutoni!

14.7.4. Si një **modus operandi**, aktivizmi gjyqësor kushtëzohet nga disa faktorë, të cilët ndikojnë në shkallën e tij. Jo vetëm kaq! Krahas faktorëve që kushtëzojnë aktivizmin gjyqësor ekzistojnë disa parametra të cilët kanë **natyrë juridike-kushtetuese**, por edhe disa të tjerë që nuk kanë këtë natyrë, përkatësisht që kanë **natyrë ekstra-juridike**. Përzgjidhni pesë aktgjykime të **GJKRKS** që bazohen në parametra juridiko-kushtetues dhe pesë të tjerë që nuk bazohen në kësi parametra, përkatësisht që bazohen në parametra ekstra-kushtetues. Këtu mund të përdorni si aktgjykimet në rastet e kërkesave individuale (ato që mbajnë shenjën **KI**) ashtu edhe aktgjykimet e dhënë në rastet e kërkesave që nuk kanë karakter individual (ato që përmbajnë shenjën **KO**). Pasi t'i keni përzgjedhur, diskutoni se cilat parametra dominojnë më shumë praktikën gjyqësore të reflektuar në këto dhjetë aktgjykime që janë objekt i analizës suaj.

14.7.5. Në literaturë është vërejtur se rritja e aktivizmit gjyqësor ka shkuar krah për krah me zgjerimin e kompetencave juridiksionale të gjyqësisë kushtetuese. Kjo rritje, në të njëjtën kohë, ka pasuar si rezultat i ngritjes së fuqisë normative të kushtetutave nacionale, të cilat, pas vitit 1945 në veçanti, më nuk shiheshin si dokumente programatike por si tekste juridike që i nënshtrohen teknikave të interpretimit. Këto teknika, megjithatë, ishin më të ndryshme nga ato që zbatoheshin për ligje dhe aktet tjera juridike: normat, vlerat dhe parimet kushtetuese përmbanin kuptime të pafund, duke iu lënë interpretuesve hapësirë të madhe për zgjidhjen e dykuptimësive të tekstit. Kjo pati për pasojë krijimin e rezervave ndaj gjyqësisë kushtetuese. Në fakt, vetë aktiviteti i parë i gjyqësisë kushtetuese, **ligjvënia negative**, u pa si aktivizëm i çuditshëm gjyqësor. Diskutoni!

14.7.6. Mund të thuhet se, në parim, aktivizmi gjyqësor ekziston kur gjykata me rastin e vendosjes së një rasti apo zgjidhjes së një mosmarrëveshjeje kushtetuese tejkalon parametrat matës. Ata parametra

[234] "Nations in Transit – Kosovo 2012". *FREEDOM HOUSE*, fq. 279-295 në fq. 280, 286 & 291-292. Në internet: https://www refworld.org/docid/4fd5dd2dc.html (shikuar në shkurt 2019); & "Nations in Transit – Kosovo 2013". *FREEDOM HOUSE*, fq. 283-301 në fq. 286. Në internet: https://freedomhouse.org/sites/default/files/ NIT 13Kosovo2ndProof.pdf (shikuar në maj 2019).

matës gjenden në tekstet juridiko-kushtetuese dhe në praktikën gjyqësore të vetë gjykatës kushtetuese. Kjo nënkupton se, çdokush që dëshiron të vlerësoj nëse ka pasur tejkalim të parametrave matës dhe aktivizëm gjyqësor duhet të analizojë silogjizmin gjyqësor që ka ndjekur gjykata me rastin e vendosjes apo zgjedhjes së mosmarrëveshjes kushtetuese konkrete. Për çfarë bëhet fjalë këtu? Në veçanti tregoni dhe diskutoni se çka paraqitet si premisë e sipërme (**premisa major**) e një silogjizmi gjyqësor që vlerësohet e çka premisë e poshtme (**premisa minor**).

14.7.7. Në sferën e dizajnit institucional të gjykatave kushtetuese, juridiksioni i gjykatave kushtetuese në sferën e kontrollit abstrakt të normës juridike paraqet strofullin kryesor ku u ankorua mundësia për **aktivizëm gjyqësor**. Më vonë këtij strofulli iu janë shtuar edhe kompetencat të tjera, siç është kompetenca e gjykatave kushtetuese për kontrollin e kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese. Përveç këtyre dy kompetencave specifike, ekzistojnë edhe disa kompetenca tjera që më vonë iu janë shtuar gjykatave kushtetuese dhe që kanë shërbyer si kuadër për aktivizmin e tyre gjyqësor. Për cilat kompetenca tjera shtesë bëhet fjalë? Cili ka qenë dhe ngelet qëllimi kryesor i tyre, i cili në të njëjtën kohë ka shërbyer dhe shërben si shkak potencial i aktivizmit gjyqësor? Pse në sistemin e të drejtës së përgjithshme të Britanisë së Madhe nuk u bë e mundur që rasti **Dr. Bonham** të luaj rolin e njëjtë që kishte luajtur rasti **Marbury vs Madison** në **SHBA**?

14.7.8. Në sferën e kontrollit kushtetues të ushtrimit të pushtetit konstituiv (**origjiner** dhe **derivativ**), aktivizmi gjyqësor dallon dukshëm, siç dallon edhe vetë mënyra e ushtrimit të këtij pushteti. Cilët parametra i merr parasysh një gjykatë kushtetuese kur kontrollon kushtetutshmërinë e **pushtetit konstituiv origjiner** e cilët parametra kur kontrollon ushtrimin e **pushtetit konstitutiv derivativ**?

14.7.9. A ka pasur ndonjë rast kur **Kosova** ka ushtruar **pushtet konstituiv origjiner**? A ka ushtruar Gjykata Kushtetuese ndonjëherë kontroll kushtetues të kushtetutshmërisë së pushtetit konstitutiv origjiner dhe cilët janë parametrat matës me të cilët Gjykata shërbehet në rastet e ushtrimit të këtij lloji kontrolli? Tregoni në veçanti se në çka konsiston ushtrimi i pushtetit konstitutiv origjiner dhe çfarë dallon ai nga ushtrimi i pushtetit konstituiv derivativ.

14.7.10. Ma arsimtarin tuaj, analizoni **Aktgjykimin lidhur me përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur** të vitit 2012. Në veçanti shikoni të jepni përgjigje nëse këtu kemi të bëjmë me ushtrimin e pushtetit konstituiv origjiner apo të pushtetit konstitutiv derivativ. Krahas kësaj, analizoni dhe diskutoni se cilët kanë qenë parametrat matës që Gjykata Kushtetuese i ka përdorur me rastin e nxjerrjes së këtij Aktgjykimi.

14.7.11. Ndër rastet që në diskursin publik, në mënyrë të gabuar janë vlerësuar si aktivizëm gjyqësor, hyn edhe rasti i themelimit të **Gjykatës Speciale**. Ky rast ka pasur për objekt kontrollin kushtetues të një amendamenti kushtetues, amendamenti nr. 24 (neni 162 i Kushtetutës së vitit 2008), që nënkupton se fjala ka qenë për kontrollin kushtetues të ushtrimit të pushtetit konstituiv derivativ. Për dallim nga rastet tjera të kontrollit kushtetues të ushtrimit të pushtetit konstituiv derivativ, ky rast ka pasur për bazë parametra tjerë kushtetues për matje të kushtetutshmërisë. Për cilët parametra tjerë bëhet fjalë dhe në cilin nen të Kushtetutës ankorohen parametrat e tillë matës? Lexoni me kujdes Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetues që bën kontrollin kushtetues të amendamentit nr. 24 (neni aktual 162 i Kushtetutës) dhe gjeni parametrat matës që ka përdorur Gjykata në për vlerësim të kushtetutshmërisë, në veçanti vlerësoni nëse mbështetja e Gjykatës në zgjidhjet nga **e drejta kushtetuese komparative** kanë qenë me vend?

14.7.12. Në praktikën gjyqësore të **Gjykatës Kushtetuese** gjatë gjashtë vjetorit të parë të punës së saj janë nxjerrë disa vendime që kanë pasur ndikim të madh në zhvillimin e kushtetutshmërisë në vend, që nga roli dhe pozita e vetëqeverisjes lokale, ndarjen dhe balancimin e pushtetit qendror, promovimi dhe avancimi i lirive dhe të drejtave kushtetuese dhe kështu me radhë. Një pjesë e tyre plotësojnë kushtet për t'u cilësuar si aktivizëm gjyqësor, kurse tjerat vetëm në dukje janë të tilla sepse në brendi fare nuk mund të kualifikohen si vendimet të proveniencës së aktivizmit gjyqësor. Përzgjidhni nga dy aktgjykime të secilit grup dhe diskutoni pse janë dhe pse nuk janë aktiviste vendimet e përzgjedhura. Kur ta nisni

këtë proces, listoni parametrat kushtetues që shërbejnë si matës të aktivizmit gjyqësor apo të mungesës së tij në rastin e vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese, të përzgjedhur nga vetë ju dhe arsimtari i lëndës.

14.7.13. Në rastin e a.q. të **imuniteteve**, të cilin e ka vendosur Gjykata Kushtetuese, janë sqaruar caqet dhe llojet e imunitetit të funksionarëve të lartë shtetëror të Kosovës, përfshirë deputetët e saj. Në aspektin e aktivizmit gjyqësor, ky rast nuk përbën ndonjë risi të veçantë sepse është njëri ndër rastet e njohjes së cilësisë së palës së autorizuar shefit të shtetit dhe shefit të qeverisë, pa marrë parasysh se si objekt kontrolli kushtetues nuk paraqitet një akt juridik ashtu siç kërkohet nga neni 113 parag. 1 & 2 i Kushtetutës. Lexoni këtë rast me kujdes dhe diskutoni nga këndi i caqeve dhe llojeve të imunitetit, duke vlerësuar nëse argumentet e Gjykatës Kushtetuese nga sfondi i të drejtës kushtetuese komparative kanë qenë parametër i mjaftueshëm për matjen e kushtetutshmërisë së caqeve dhe llojeve të imuniteteve që funksionarët shtetërorë kosovarë, përfshirë deputetët e Kosovës, duhet t'i gëzojnë.

14.7.14. Edhe në **rastin e pensioneve të FSK-së**, Gjykata ka konstatuar dhe pranuar se pyetjet që ishin parashtruar nga Shefi i Shtetit kishin natyrë kushtetuese. Ato ishin parashtruar në bazë të dispozitës së nenit 84.9 të Kushtetutës. Kjo nënkuptonte se rasti, për pasojë, duhej të konsiderohej i pranueshëm për shqyrtim dhe vendosje, pa marrë parasysh kërkesat e nenit 113.1 të Kushtetutës, të cilat e thonë të kundërtën e kësaj. Kjo këtu nuk ka rëndësi. Ajo që ka rëndësi këtu lidhet me objektin e kontrollit kushtetues, gjë që nuk ka qenë i njëjtë me rastet e sipërcekura. Lexoni me kujdes aktgjykimin për këtë rast dhe bëni krahasimin e këtij rasti me rastet tjera si më sipër kur Gjykata ka ushtruar aktivizëm gjyqësor në sferën e pranueshmërisë (procedurale), duke u bazuar në nenin 84.9 dhe 93.10 të Kushtetutës. Krahasoni këtë rast në veçanti me rastin **VLAN I** dhe rastin e **Asociacionit Serb**.

14.7.15. Gjykata Kushtetuese ka bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë së ushtrimit të **pushtetit konstitutiv derivativ** nga ana e **Kuvendit të Kosovës.** I pari i këtij lloji ka qenë rasti i njohur si **Logoja e Prizrenit.** Pasi ta keni lexuar këtë rast, gjeni edhe pesë raste të tjera kur Gjykata ka ushtruar kontrollin e kushtetutshmërisë së **pushtetit konstituiv derivativ** dhe analizoni në grup argumentet **ekstra-kushtetuese** dhe **ekstra juridike** të përdorura nga Gjykata. Në fund jepni dallimin në mes të këtyre vendimeve dhe atyre që kanë të bëjnë me ushtrimin e pushtetit konstitutiv origjiner.

Shënojmë se në Kosova, akoma nuk ka pasur praktikë gjyqësore që ka të bëjë me ushtrimin nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kontrollit kushtetues ndaj ushtrimit të pushtetit konstitutiv origjiner. Ky nuk është rasti me ushtrimin e pushtetit konstitutiv derivativ, të cilin e ka ushtruar disa herë Kuvendi i Kosovës dhe, për pasojë, Gjykata ka pasur rast të bëj vlerësimin e kushtetutshmërisë së ushtrimit të këtij pushteti.

14.7.16. Ideja e kushtetutës si **dokument i gjallë** ka histori të gjatë në diskursin nacional amerikan, ku edhe ka lindur. Kush e ka përdorur këtë term i pari? Cili është kuptimi i tij? Dhe, mbi të gjitha, cili është funksioni i idesë mbi kushtetutën si **dokument i gjallë**: cilit qëllim i shërben?

14.7.17. Një koncept që ka lindur në Evropë pas **Luftës së Dytë Botërore** me themelimin e gjykatave kushtetuese i ngjason shumë konceptit amerikan të **kushtetutës së gjallë**. E kemi fjalën për konceptin italian të **diritto vivente**, që më pastaj është përqafuar nga vendet tjera nëpër Evropë dhe gjetiu. Diskutoni në klasë me arsimtarin e lëndës, duke provuar kontekstualizimin e këtij koncepti në realitetin kosovar. Në veçanti jepni dallimin e këtij koncepti me atë amerikan të kushtetues si dokument i gjallë dhe me një koncept tjetër që më shumë asocohet me aktivizëm gjyqësor të përmasave dramatike në krahasim me dy këto koncepte të cekura më sipër. E kemi fjalën për të a.q. **kushtetutën e padukshme** (**invisible constitution**), që është krijuar nga kryetari i parë i **GJKHu,** *László* Sólyom, për t'u zbatuar nga ajo në vazhdimësi në vitet e para formative të saj. Diskutoni për tri këto koncepte (kushtetuta si "dokument i gjallë", si "diritto vivente" dhe si "invisible constitution"), të përbashkëtat dhe dallimet në mes të tyre.

14.7.18. Koncepti italian i **diritto vivente** ka gjetur zbatim edhe në praktikën gjyqësore të **Gjykatës së Strasburgut**, siç ka gjetur edhe koncepti i amerikan mbi kushtetutën si **dokument i gjallë**. Kjo praktikë, megjithatë, i ngjason më shumë konceptit amerikan se atij italian. Tregoni arsyet pse praktika gjyqësore

e **Gjykatës së Strasburgut** më shumë i ngjason konceptit amerikan të kushtetutës si një **dokument i gjallë** se konceptit italian mbi **diritto vivente**. Në rastin e Gjykatës së Strasburgut, megjithatë, për KEDNJ, e cila përbën "kushtetutën" e saj, përdoret shprehja **living instrument**. Diskutoni!

14.7.19. Termi **instrument i gjallë**, i zhvilluar në praktikën e **Gjykatës së Strasburgut,** ka çuar në përqafimin dhe zgjerimin e lirive dhe të drejtave të garantuara me **KEDNJ** konform zhvillimeve moderne dhe ndryshimeve në qasjet mbizotëruese shoqërore. Në këtë kuptim, më emblematik është neni 8 ["E drejta për respekt të jetës private dhe familjare"] të **KEDNJ** dhe interpretimi që ky nen ka fituar në praktikën e **GJEDNJ.** Gjeni tri raste nga praktika gjyqësore e **Gjykatës së Strasburgut** në kohën deri në vitin 1990 dhe tri të tjera pas këtij viti deri në kohën e leximit të këtij kapitulli dhe diskutoni në klasë me qëllim të gjetjes së dallimeve në interpretim të këtij neni, përkatësisht me qëllim të analizimit të evoluimit të doktrinës mbi **KEDNJ** si një **instrument i gjallë.**

14.7.20. Në kontekstin kosovar, dy vendime të Gjykatës Kushtetuese janë me rëndësi për t'u zënë në gojë, në publik të njohura respektivisht si **rasti i qarkores qeveritare** dhe **rasti i rrogave**, të cilat vlen të analizohen me qëllim të vetëm që lexuesit t'i kontekstualizohet shkalla e aktivizmit gjyqësor në sferën e përligjjes nga ana e Gjykatës Kushtetuese të aktivitetit ligjvënës të ekzekutivit kosovar. Demonstroni në klasën tuaj këtë kontekstualizim, duke u bazuar edhe në mendimet mospajtuese të dy gjyqtarëve në **rastin e rrogave**, ku më shumë ka referime që cojnë në të drejtën kushtetuese komparative. Në fakt, rasti i **vendimit për rrogat** duhet të shikohet në dritën e jurisprudencës së mëhershme të **GJKRKS**. Pa këtë nuk mund të kuptohet aktivizmi gjyqësor në këtë rast. Për cilën praktikë të mëhershme të Gjykatës Kushtetuese bëhet fjalë në rastin e vendimit për rrogat?

Sa i përket rastit të parë, ndërkaq, diskutimi juaj duhet të fokusohet në aktivizmin gjyqësor, duke treguar se ku qëndron gabimi i aktivizmit të Gjykatës në këtë rast. Ai aktivizëm, në fakt, lidhet me natyrën e Gjykatës Kushtetuese si një ***pouvoir constitué*** krejtësisht e veçantë që rri mbi të gjitha pushtetet tjera të konstatuara. Çfarë do të thotë kjo? Çfarë ka thënë Gjykata Kushtetuese për këtë natyrë të Gjykatës Kushtetuese në rastin e parë, përkatësisht në **rastin e qarkores qeveritare**?

14.7.21. Ekzistojnë disa forma të manifestimit të aktivizmit gjyqësor në sferën e kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së normave. Forma më drastike e këtij aktivizmi është aktiviteti i gjykatave kushtetuese që njihet me emrin **ligjvënie pozitive**, nisur nga fakti se këtu gjykatat kushtetuese uzurpojnë prerogativat e sovranit dhe përfaqësuesit të tij duke zëvendësuar pikëpamjet e veta me ato të sovranit apo përfaqësuesit të tij. Tregoni cilat janë katër format e manifestimit të këtij aktivizmi gjyqësor drastik. Tregoni po ashtu nëse abstenimi apo pasiviteti gjyqësor hyn në konceptin e aktivizmit drastik të gjykatave kushtetuese dhe, nëse po, tregoni pse kjo është kështu.

14.7.22. Arsyet për **aktivizëm gjyqësor** të gjykatave kushtetuese në sferën **e lirive dhe të drejtave të njeriut** janë të njëjta në dy anët e **Atlantikut**. Çfarë do të thotë kjo? Diskutoni në klasë, pasi të keni analizuar seksionet relevante të këtij kapitulli, ku flitet për liritë dhe të drejtat e njeriut si një sistem objektiv i së drejtës i garantuar me Kushtetutë.

14.7.23. Përveç arsyes bazike për aktivizëm gjyqësor në sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut, ekzistojnë edhe dy arsye të tjera që duhet t'i përmendni dhe analizoni duke u mbështetur në disa raste nga praktika e **Gjykatës së Strasburgut** dhe e vendeve të ndryshme ish-komuniste evropiane (si p.sh praktika e gjykatave kushtetuese të vendeve ish-komuniste me **dënimin me vdekje**, **barazinë gjinore**, të drejtat e komunitetit **LGBT** dhe kështu me radhë).

14.7.24. Çka paraqet doktrina e njohur si **vlerësimi i lirë** (**margin of appreciation**) dhe pse ekziston kjo në praktikën e **GJEDNJ**? Çfarë dhe pse e lidh këtë doktrinë me **parimin e proporcionalitetit**?

14.7.25. Çka nënkuptohet me parimin e subsidiaritetit dhe çfarë lidhje ka ky parim me **vlerësimin e lirë të gjykatave nacionale** (**margin of appreciation**)? Cila është marrëdhënia në mes të **parimit të subsidiaritetit** dhe juridiksionit të **GJEDNJ?**

14.7.26. Jashtë ushtrimit të juridiksionit material në lëmin e normëvënies (kushtetutëbërja dhe ligjbërja) dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave kushtetuese, në menynë e kompetencave të gjykatave kushtetuese ekzistojnë edhe njësi të tjera që potencialisht mund të paraqesin terren të përshtatshëm për aktivizëm gjyqësor. Për cilat kompetenca të tjera bëhet fjalë? Ose, thënë ndryshe, cilat janë kompetencat tjera të gjykatave kushtetuese, jashtë kontrollit kushtetues të normave juridike dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave kushtetuese që kanë shërbyer si hapësirë juridiksionale për ushtrim të aktivizmit gjyqësor?

14.7.27. Afatet për vendimmarrje në gjyqësinë kushtetuese janë pjesë e procedurës. Mosmarrja e vendimit në kohën e përcaktuar me kushtetutë dhe ligj që normon organizimin dhe funksionimin e një gjykate kushtetuese, apo mosvendosja në një kohë të arsyeshme (në rastet kur nuk ekziston një afat kushtetues dhe ligjor për vendimmarrje, siç është rasti me kërkesat sipas ankesës kushtetuese), në shikim të parë mund të duket si një instrument i **vetëpërmbajtjes gjyqësore**. Kjo, megjithatë, nuk është kështu. Tregoni arsyet pse kjo është ndryshe nga që duket në pamje të parë!

14.7.28. Të lidhura ngushtë me afatet dhe respektimin e tyre si një **loci** për ushtrim të **aktivizmit gjyqësor** janë edhe dy situata të tjera, që kanë natyrë procedurale dhe në të cilat flen potencialisht aktivizmi i gjyqtarëve kushtetues. Situata e parë ka të bëjë me shpalljen si të palejueshme për gjykim dhe vendosje meritore të rasteve të paraqitura në gjykatë. Ngushtësisht e lidhur me këtë është situata e dytë, që ekziston atëherë kur gjykata kushtetuese me vendim jomeritor, që në Kosovë quhet **aktvendim**, vendos për ndryshimin e precedentit të krijuar me vendim meritor, i cili në **Kosovë** dhe në një pjesë të madhe të vendeve që kanë gjyqësi kushtetuese quhet **aktgjykim**. Diskutoni situatën e parë, kur procedura mbyllet me aktvendim dhe kur mund të krijohen situata paradoksale për gjyqësinë kushtetuese dhe për palët, me referim të veçantë në rastin **Emrush Kastrati**.

14.7.29. Në rastin e vendimeve mbi kërkesat individuale, të cilat mbajnë shenjën **KI**, efekti i tyre është **inter partes**. Kjo do të thotë se aktivizmi në këtë fushë prek interesat e palëve në procedurë. Ka përjashtime nga kjo rregull, por që këtu nuk na hyjnë në punë: për hirë të thjeshtëzimit dhe për shkaqe të teoretizimit, e marrim si të mirëqenë këtë efekt **inter partes** të vendimeve në rastet e kërkesave individuale. Ky nuk është rasti me kërkesat që iniciohen nga palët e privilegjuara (shefi i shtetit dhe i qeverisë, një numër i caktuar i deputetëve, avokati i popullit dhe kështu me radhë). Çdo aktivizëm gjyqësor në procedurat sipas kërkesave të palëve të privilegjuara, për pasojë, prek interesin publik dhe shkakton dëm më të madh dhe ka efekt sistemik. Të kësaj natyre janë dy vendime të Gjykatës Kushtetuese, të cilat kanë prishur dhe prishin sigurinë juridike të qytetarëve dhe hapin rrugë për shkatërrim të përvojës modeste me sundimin e ligjit të krijuar në Kosovë. Ato vendime janë **rasti i Presidentit Thaçi** dhe **rasti i Gjykatës Speciale**. Diskutoni këto dy raste, pasi të keni analizuar vendimet e tyre në origjinal.

14.7.30. Për qëllimet e të kuptuarit të aktivizmit gjyqësor, dy teknika interpretimi ekzistojnë në përvojat e gjyqësisë kushtetuese evropiane dhe më gjerë. E para ndër to është e a.q. **teknika e përqafimit** (**deference**), kurse e dyta është e a.q. **teknika e interpretimit konform-kushtetutës** (**constitution-conform interpretation**). Secila nga këto teknika prodhon pasojat e caktuara që kanë të bëjnë me intensitetin dhe caqet e aktivizmit gjyqësor. Diskutoni!

14.7.31. Teknika e parë e interpretimit në një gjykim kushtetues, **teknika e përqafimit** (**deference**), vjen në shprehje si në marrëdhënien e gjykatave kushtetuese me ligjvënësin ashtu edhe në marrëdhëniet e këtyre dyjave me gjyqësorin e rregullt. Në rastin e parë ekzistojnë disa forma të manifestimit të respektit apo përqafimit të ligjvënësit dhe produktit të tij nga ana e gjykatës kushtetuese. Ato forma janë: **prezumimi i kushtetutshmërisë së ligjeve** dhe qasja e ekskluzivisht si **ligjvënës negativ.** Çfarë nënkuptohet më njërën e çka me tjetrën formë?

14.7.32. Në praktikën e Gjykatës Kushtetuese ekzistojnë dy vendime të rëndësishme që kanë trajtuar çështjet e **ligjvënies negative**. Njëri nga to është vendim meritor apo aktgjykim, kurse tjetri vendim për masën e përkohshme. Në të dyja rastet, sa për ilustrim të përzgjedhura, efekti ka qenë i njëjtë: anulimi efektiv i dispozitave specifike ligjore që nuk kanë qenë në pajtueshmëri me Kushtetutën. E kemi fjalën

për rastin e **RTK** dhe **rastin e Pensioneve të Deputetëve**. Lexoni me kujdes dy këto vendime dhe bëni komentet tuaja rreth **ligjvënies negative**, duke u bazuar në arsyetimin e dhënë nga Gjykata dhe doktrinën e **Hans Kelsen** mbi këtë koncept.

14.7.33. Në thelb, **prezumimi i kushtetutshmërisë së ligjeve** që çon në anulim të dispozitave specifike të ligjit nuk është ndonjë respektim i këtij prezumimi dhe i vullnetit të përfaqësuesit të sovranit nacional – parlamentit. Kur dhe pse është prezumimi në fjalë respektim i vullnetit të sovranit nacional – parlamentit?

14.7.34. Cili është dallimi në mes të **prezumimit të kushtetutshmërisë së ligjeve** dhe **vetëpërmbajtjes gjyqësore**?

14.7.35. **GJKRKS** në disa raste ka hedhur poshtë si qartazi të pabazuar kërkesën për vlerësim të kushtetutshmërisë së ligjeve, duke konfirmuar kështu prezumimin e kushtetutshmërisë së produktit të Kuvendit të Kosovës. E njëjta nuk mund të vlejë për produktin e Qeverisë, pra nuk mund të ketë prezumim të kushtetutshmërisë së veprimit ekzekutiv. Në këto raste, **aktivizmi gjyqësor** ankorohet në arsyetimin e verdiktit të gjykatave kushtetuese, i cili, në shenjë respekti, përligjëson punën dhe produktin e ekzekutivit që është nxjerrë në mënyrë jokushtetuese. Kjo më së miri shihet te vendimi për **rastin e Rrogave**, ku Gjykata ka konfirmuar në mënyrë shumë arbitrare kushtetutshmërinë e një vendimi individual të ekzekutivit kosovar. Lexoni me kujdes këtë vendim dhe gjeni pjesët e arsyetimit arbitrar dhe aktivizmin e GJKRKS!

14.7.36. Ndjekja e një qëllimi legjitim, respektimi i parimit të proporcionalitetit nga ana e ligjëvënësit, moskufizimi i panevojshëm dhe disporporcional i lirive dhe të drejtave të garantuara me Kushtetutë janë përbërësit themelor të legjitimitetit kushtetues të një ligji. Plotësimi i këtyre kushteve shënon fazën e kalimit të testit dhe konfirmim i kushtetutshmërisë së ligjit. Lexoni më kujdes **rastin e Investimeve Strategjike**, të vendosur nga Gjykata Kushtetuese, dhe gjeni pjesët që diskutojnë plotësimin e këtyre kushteve si më sipër dhe konfirmimin e legjitimitetit kushtetues të ligjit që ka qenë objekt i kontrollit kushtetues.

14.7. 37. Teknika e parë apo teknika e **përqafimit** (**deference**) paraqet një teknikë gjykimi ku reflektohet marrëdhënia e gjykatave kushtetuese me gjyqësorin e rregullt. Kjo nënkupton se nuk është vetëm marrëdhënia e gjykatave kushtetuese me ligjvënësin që komandohet përmes kësaj teknike. Në rastin e marrëdhënieve të gjykatave kushtetuese me gjyqësorin e rregullt vijnë në shprehje dy forma të manifestimit të kësaj teknike: forma **e drejta e gjallë** (**living law**) dhe parimi i **subsidiaritetit**. Çfarë do të thotë kjo?

14.7.38. Teknika e dytë, e a.q. teknika e **interpretimit konform-kushtetutës** (**constitution-conform interpretation**), paraqet teknikën që më së shumti shkakton aktivizëm gjyqësor. Në kontekst të zbatimit të kësaj teknike, në literaturë është folur si për një **kirurgji gjyqësore** të normave juridike, të cilën e kryejnë gjykatat kushtetuese gjatë kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë. Esenca e saj konsiston në atë se norma juridike nuk anulohet por lejohet të vazhdojë jetën e vet, mirëpo në mënyrën e përcaktuar nga gjykata kushtetuese. Diskutoni modalitetet e kësaj teknike, në veçanti situatat që lidhen me të a.q. **kirurgji gjyqësore**, që prodhohet me rastin e vënies në jetë të kësaj teknike.

14.7. 39. Çfarë nënkuptohet me **vetëpërmbajtjen gjyqësore** dhe cilat janë premisat themelore të saj? Tregoni në veçanti për si vijon: 1. cilat janë pikat e përbashkëta në mes të vetëpërmbajtjes gjyqësore dhe prezumimit të kushtetutshmërisë së ligjeve? 2. cilat janë format e manifestimit të vetëpërmbajtjes gjyqësore? dhe, së fundi, 3. cila është lidhja në mes të aktivizmit gjyqësor, **abdikimit** dhe vetëpërmbajtjes gjyqësore?

14. 7. 40. Në praktikën e Gjykatës Kushtetuese ka pasur mjaft raste kur është vendosur përmes përdorimit të teknikës së vetëpërmbajtjes gjyqësore. Sa për ilustrim japim rastet si vijon: **rastin e Veteranëve**, **rastin Trepça** dhe **rastin e Imuniteteve.** Lexoni dhe analizoni tri këto raste, pastaj ndani rolet dhe bëni gjetjet tuaja sa i përket anëve pozitive dhe anëve negative të **vetëpërmbajtjes gjyqësore**, të cilën e ka ushtruar Gjykata në këto raste.

14. 7. 41. Në rastin e tretë të **vetëpërmbajtjes gjyqësore**, për dallim te rastet e aktivizmit gjyqësor, e keqja paraqitet edhe më e madhe . Kjo është kështu sepse vetëpërmbajtja, gjyqësinë kushtetuese, si instancë e fundit për ndreqjen e shkeljeve kushtetuese dhe sigurimin e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës, e komprometon dhe e bën të paefektshme në sytë e qytetarit. Kjo në veçanti vlen për vendet që kultivojnë **ankesën e plotë** apo **gjysmë të plotë** kushtetuese. Çfarë do të thotë kjo?

14. 7. 42. Një rast i rëndësishëm i **vetëpërmbajtjes gjyqësore** në sferën procedurale, e cila në fakt nuk është e tillë, paraqet rasti i **anulimit të cilësisë së palës së privilegjuar të shefit të shtetit dhe qeverisë jashtë juridiksionit material** nga neni 113. parag. 2 & 3 ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] i Kushtetutës. Ky autorizim në dobi të këtyre dy organeve kushtetuese ka ndodhur me vendim meritor, me aktgjykim, dhe ka qenë rezultat i aktivizmit gjyqësor të **Gjykatës Kushtetuese**. Në shikim të parë, ndryshimi i kësaj praktike me vendim jomeritor, me aktvendim, sikur len përshtypjen se fjala është për **vetëpërmbajtje gjyqësore**. Ky, në fakt, nuk është rasti. Pse?

14. 7. 43. Analizoni tri rastet si vijon: **rasti Pasaportat**; **rasti Fadil Hoxha dhe të tjerë**t dhe **rasti Kryeprokurori i Shtetit**. Pasi të keni bërë analizimin e tyre, diskutoni me qëllim të gjetjes së ngjashmërive dhe të dallimeve në mes tyre.

14.7. 44. Pse në rastet **Pasaporta**, **Fadil Hoxha dhe të tjerët** dhe **Kryeprokurori i Shtetit** nuk mund të bëhet fjalë për vetëpërmbajtje gjyqësore, përkatësisht çfarë do të ndodhte sikur Gjykata Kushtetuese të kishte vendosur për të qëndruar anash, për t'u vetëpërmbajtur, ashtu që tri rastet të ishin shpallur të papranueshme për shkak të mosshterjes së mjeteve juridike efektive?

14.7. 45. Në rastet **Pasaporta**, **Fadil Hoxha dhe të tjerët** dhe **Kryeprokurori i Shtetit**, Gjykata ka arsyetuar mosshterjen e mjeteve juridike efektive duke u bazuar në dy argumente. I pari ka të bëjë me atë se rendi juridik kosovar nuk ka ofruar në rastet e cekura më sipër mbrojtje efektive juridike, përkatësisht mjete formale dhe joformale që pala do të mund t'i përdorte me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të garantuara kushtetuese. Me çfarë ka të bëj argumenti i dytë, të cilin Gjykata e ka futur në arsyetimin e vet të vendimit në tri rastet si më sipër, por edhe në të gjitha rastet tjera kur ka anashkaluar mosshterjen e mjeteve juridike si kriter për lejueshmëri të një ankese kushtetuese? Shënojmë se ky argument i Gjykatës në tërësi mbështetet në precedentët e **Gjykatës së Strasburgut**. Diskutoni!

14.7.46. Në rastet **Pacolli** dhe **Imunitetet** ka pasur akuza në drejtim të Gjykatës për aktivizëm gjyqësor. Lexoni më vëmendje dy këto raste dhe krahasoni argumentet e dhëna në dy aktgjykimet e Gjykatës që kanë origjinë nga provenienca e të drejtës kushtetuese komparative dhe nga e drejta diplomatike. Në veçanti provoni të evidentoni dhe argumentoni paragrafët argumentative të Gjykatës në këto dy raste që mund të çojnë kah mendimi që mund ngjason me një aktivizëm gjyqësor të saj.

14.7.47. Me kulturë kushtetuese nuk nënkuptohet mënyra e jetesës, siç ndodhë në të folurit e përditshëm, por një koncept shumë i strukturuar dhe me përmbajte diverse. Në aspektin strukturor, kultura kushtetuese përbëhet nga **prodhimet dhe refleksionet mendore** lidhur me **objektet politike**. Çka nënkuptohet me njërin koncept e çka me tjetrin? Në veçanti tregoni se cilët janë përbërësit kryesor të **objekteve politike**?

14.7.48. Në literaturën e të drejtë kushtetuese komparative është vërejtur se **GJKAJu** ka dhënë një kontribut të madh në sigurimin e mosdiskriminimit dhe të barazisë së njerëzve para ligjit dhe në të drejta. Kjo vjen në shprehje në veçanti në vendimet e saj që kanë pasur të bëjnë me eliminimin e mbetjeve të sistemit diskriminues të **Apartheid**-it. Këto vendime zakonisht kanë cituar burime ekstra-juridike dhe ekstra-kushtetuese të së drejtës me qëllim të realizimit të misionit të saj kushtetues. Për çfarë bëhet fjalë këtu dhe në çfarë aspekti ky vend dhe gjyqësia e tij kushtetuese ngjasojnë me Kosovën?

14.7.49. Në **Australi** ekziston një sistem juridik i të **drejtës së përgjithshme**, krahas ndikimit të fuqishëm të **sistemit kontinental** (**civil**) të së drejtës së shkruar. Cili nga këto dy sisteme juridike kanë qenë shkaktar të aktivimit gjyqësor në këtë vend?

14.7. 46. Ekzistojnë tri segmente në gjyqësinë kushtetuese të Austrisë që çojnë peshë në të kuptuarit e aktivizmit gjyqësor në këtë vend, krahas të kuptuarit e juridiksionit standard që ka **GJKAu**, i cili ka të bëj me kontrollin abstrakt të normës dhe juridiksionin që lidhet me kontrollin kushtetues të vendimeve gjyqësore në lëmin administrativ. Cilat janë këto tri segmente?

14.7. 50. Në rastin e **Brazilit**, aktivizmi gjyqësor shprehet në një mënyrë edhe më specifike, diçka që është parë më herët në vendet në tranzicion. Për çfarë bëhet fjalë këtu?

14.7. 51. Nën ndikimin e teorisë dhe praktikës gjermane, **GJK**Çe ka dhënë një kontribut të çmuar në sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut, duke shtypur formalizmin juridik dhe interpretimin tekstual që është trashëguar nga e kaluara. Këtu nuk e kemi fjalën vetëm për vënien në jetë të efektit vertikal të lirive dhe të drejtave kushtetuese, por edhe të atij horizontal. Diskutoni!

14.7.52. Në **Francë** ekziston **KKFr**, një organ kvazi-gjyqësor. Historia e krijimit të tij ka qenë mjaft e trazuar dhe është përcjellur më një përparim gradual në ngritje të statusit të tij kushtetues. Kjo ngritje e këtij statusi, duke e shndërruar në një gjykatë të vërtetë kushtetuese, ka ardhur pikërisht si rezultat i aktivizmit të tij gjyqësor. Tregoni këtu se kur dhe si ka nisur aktivizmi gjyqësor i **KKFr** dhe si ka çuar ky aktivizëm në ndryshimet kushtetuese që sot i njohin këtij organi statusin e një gjykate kushtetuese. Në veçanti tregoni aktivizmin e tij gjyqësor në sferën i identifikimit të burimeve të së drejtës kushtetuese .

14.7.53. Në **Gjermani** pas Luftës së Dytë Botërore ka ardhur deri të ndryshimi radikal në sistemin politik dhe kushtetues. Ky ndryshim është reflektuar edhe në gjyqësinë kushtetuese. Diskutoni kahet kryesore të ndryshimeve në sferën e gjyqësisë kushtetuese gjermane nga këndvështrimi i aktivizmit gjyqësor, duke u fokusuar në veçanti në shkaqet objektive të këtij aktivizmi!

14.7.54. Cilat janë cilësitë themelore të aktivizmit gjyqësor hungarez dhe cilës periudhë të punës së **GJKHu** i takojnë? Tregoni arsyet pse ka ndryshuar qasja e hungarezëve ndaj aktivizmit gjyqësor dhe ku ka nisur ky ndryshim?

14.7.55. Italia paraqet një rast shumë interesant për sa i përket zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese. Në këtë kanë ndikuar dy faktorë: **kultura kushtetuese italiane** dhe **sistemi politik italian.** Diskutoni!

14.7.56. Në **Kanada** ka pasur një zhvillim kushtetues të ngjashëm me ish - kolonitë tjera britanike, me një dallim që këtu, pas vitit 1982, një ndikim të madh ka nisur të ushtroj dhe ushtron akoma edhe **Gjykata Supreme Amerikane**. Kjo për shkak se në këtë vit është nxjerrur kushtetuta permanente e shkruar e **Kanadasë**. Që nga kjo kohë, aktivizmi gjyqësor, në përpjekjet për të siguruar supremacinë (epërsinë) e Kushtetutës ka qenë i dallueshëm. Në këtë kuptim, ekzistojnë dy forma të shpresoj së këtij aktivizmi gjyqësor. Cilat janë ato dy forma të manifestimit të aktivizmit gjyqësor kanadez dhe në çka konsistojnë ato? Në veçanti tregoni rastet në të cilat ndodhën këto dy forma të aktivizmit gjyqësor.

14.7.57. Britania e Madhe përbën bastionin kryesor të supremacisë (epërsisë) së ligjit kundrejt normëvënës gjyqësore dhe çdo norme apo veprimi tjetër juridik. Kjo është në traditën historike të këtij vendi. Me zhvillimet pas **Luftës së Dytë Botërore**, megjithatë, ka nisur erozioni i këtij koncepti britanik lidhur me supremacinë e normës ligjore dhe vullnetit të thjeshtë të Parlamentit Britanik. Erozioni i parë nis me aderimin e vendit në **BEE**, tani **BE**, i dyti me internalizimin (futjen brenda) në sistemin juridik britanez të **KEDNJ** dhe, erozioni i tretë dhe i fundit, që ka nisur me themelimin e **GJSBM**, së cilës iu njohën prerogativat për të vendosur në çështjet që kanë të bëjnë me **pushtetet e bartura** (**devolved powers**) në favor të **Uelsit**, **Skotlandës** dhe **Irlandës së Veriut**. Diskutoni modalitetet e këtij kontrolli të cilësisë së ligjeve të parlamentit britanik në këto tri situata të erozionit të supremacisë (epërsisë) së ligjit britanik, gjithnjë në kontekst të krijimit të mundësive objektive për aktivizëm gjyqësor. Çdoherë duhet pasur parasysh fakti se këtu nuk flitet për normavënie gjyqësore si formë e aktivizmit gjyqësor: ky vend është vetë simboli i kësaj normëvënie. Këtu flitet për raste potenciale të aktivizmit gjyqësor jashtë sferës së interpretimit të së **drejtës së përgjithshme** apo, thënë ndryshe, këtu bëhet fjalë për aktivizëm gjyqësor në sferën e interpretimit të ligjeve britanike dhe cenimit të supremacisë (epërsisë) së këtyre ligjeve kun-

drejt normave të tjera evropiane (që burojnë nga instrumentet e **BE** dhe nga standardet e sanksionuara në **KEDNJ**) dhe të normave të caktuara vendore (në rastet kur bëhet fjalë për situatat e krijuara nga **pushtetet e bartura** apo **devolved powers**).

14.7.58. Në **Spanjë** ka ekzistuar një traditë e gjatë e interpretimit jo-dogmatik para ardhjes në pushtete të diktatorit **Francisko Franko**. Kjo shihet qartë nga dispozitat e **Kodit Civil Spanjoll** të shekullit 19-të, që stimulonte metodën interpretuese të juristit gjerman **Savigny**, me një përjashtim që nuk parashikonte interpretimin teleologjik dhe evolutiv (sociologjik). Në aspektet tjera, kultura juridike spanjolle e interpretimit kishte për bazë tekstin, kontekstin (aktual dhe të kohë së nxjerrjes së tekstit), si dhe vetë shpirtin dhe qëllimin e normës. Diskutoni këtë pjesë të historisë kushtetuese të Spanjës, duke e krahasuar me rolin dhe pozitën e **GJKSp** pas rënies së **Frankos** nga pushteti. Në veçanti bëni krahasimin e rolit dhe pozitës së kësaj Gjykate në procedurat e nisura me ankesë kushtetuese (**amparo**) me përvojat e gjykatave simotra në **Austri**, **Gjermani**, **Itali** dhe **Kosovë**.

14.8. Lexim shtesë

- Arne Marjan Mavčič (ed.), *Constitutional Review Systems Around the World* (Vandeplas Publishing: USA, 2018);
- Erin F. Delaney & Rosalind Dixon (eds.), *Comparative Judicial Review. Research Handbooks in Comparative Constitutional Law Series* (Edward Elgar Pub: United Kingdom, 2018);
- Visar Morina, *Gjyqësia Kushtetuese* (Universiteti i Prishtinës: Prishtinë, 2017);
- Joseph Owona, *Droits constitutionnels et institutions politiques du monde contemporain*. (L'Harmattan: Paris, 2010).

15. EFEKTET, NATYRA JURIDIKE DHE ZBATIMI I VENDIMEVE TË GJYKATAVE KUSHTETUESE

Përgjithësisht. - Ky kapitull ka një strukturë më specifike në krahasim me kapitujt pararendës sepse ka më shumë ndarje e nënndarje. Kjo është kështu për shkak se kemi dashur që të reflektohet sa më shumë kompleksiteti i temës së gjyqësisë kushtetuese lidhur me vendimet, natyrën juridike dhe zbatueshmërinë e tyre.

Historikisht shikuar, lindja e gjyqësisë kushtetuese **kelseniane/evropiane** ka ngritur shumë dilema, jo vetëm sa i përket marrëdhënies së kësaj gjyqësie me degët tjera të pushtetit shtetëror, por edhe lidhur me natyrën juridike dhe efektet e vendimeve të saj. Sa i përket dilemës së parë lidhur me natyrën juridike të vendimeve të dhëna nga gjykatat kushtetuese (ose gjykatat tjera ekuivalente me to), këtë çështje zakonisht e kanë zgjidhur kushtetutat nacionale, nganjëherë edhe ligjet organike lidhur me gjykatat kushtetuese, të cilat në mënyrë shumë të qartë normojnë fuqinë e tyre juridike. Ky normim i fuqisë juridike të vendimeve të gjykatave kushtetuese (ose gjykatave të tjera ekuivalente me to) është përcaktues i pozitës së tyre në kuadër të hierarkisë së akteve juridike brenda sistemit juridiko-kushtetues nacional. Kjo fuqi juridike e vendimeve të këtyre gjykatave, zakonisht, për të mos thënë pa përjashtim, ka karakter absolut dhe shprehet me fjalën latine **erga omnes**. Karakteri absolut i fuqisë juridike të vendimeve në fjalë është i ndryshëm nga efektet e tyre juridike, të cilat shprehen me konceptet **res judicata**, **inter partes**, efektet **ex tunc** dhe **ex nunc,** etj. Sqarimet dhe analizën konceptuale të këtyre koncepteve e bëjmë në seksionin e parë të këtij kapitulli.

Në seksionin e dytë, i cili ka shumë ndarje e nënndarje, shtjellohen në mënyrë progresive llojet e vendimeve sipas dy cilësive të tyre: *e para*, për nga natyra juridike dhe, e dyta, efektet që prodhojnë për ambientin e jashtëm juridik dhe subjektet e së drejtës në një kohë dhe hapësirë të caktuar juridiksionale.

I pari nënseksion i seksionit të dytë bën fjalë për vendimet që nuk gjejnë shkelje kushtetuese, të cilat janë pjesa më e madhe dhe më standarde e produkteve të gjykatave kushtetuese. E ndërlidhur me këtë është edhe çështja e **prezumimit të kushtetutshmërisë së ligjeve** dhe përgjithësisht i aktivitetit shtetëror rutinë që zhvillohen në një shtet demokratik që bazohen në **sundim të kushtetutës**.

I dyti nënseksion i seksionit të dytë mëton të flasë për vendimet që gjejnë shkelje kushtetuese dhe modalitetet që kanë në dispozicion gjykatat kushtetuese për të menaxhuar pasojat e shkeljeve të konstatuara kushtetuese. Në luftën e tyre për menaxhimin e pasojave juridike si më sipër, gjykatat kanë krijuar lloj–lloj mënyrash për t'i menaxhuar ato. Në ato mënyra të menaxhimit hyjnë urdhëresat për një mënyrë specifike të sjelljes brenda një afati të arsyeshëm e deri te urdhëresat e ligjvënësit për të ndrequr një situatë jokushtetuese, e cila pritet të vije në të ardhmen. Këto pasoja dhe menaxhimi i tyre varet nga lloji i jokushtetutshmërisë së konstatuar me vendim të gjykatës. Këtë e vëren lexuesi nga diskutimet tona në nënseksionet tjera të seksionit të dytë të këtij kapitulli.

Sikundër shihet, në këtë kapitull kryesisht bëhet fjalë për vendimet e gjykatave kushtetuese që kanë të bëjnë me kontrollin abstrakt të normës juridike. Kjo bëhet për dy arsye: *e para*, sepse kontrolli abstrakt i normës juridike është shenja dalluese e gjyqësisë kushtetuese që nga lindja e saj e deri më sot; dhe, e dyta, sepse ky lloj juridiksioni përbën cilësinë definuese të gjyqësisë kushtetues si një aktivitet specifik shtetëror.

Pikërisht për këtë arsye edhe diskutimi ynë në seksionin e tretë rreth strukturës dhe llojit të argumentit kushtetues kryesisht ka të bëjë me vendimet e dhëna në procedurat e kontrollit abstrakt të normës. Aty ku ka përjashtime nga kjo rregull, lexuesi e sheh në mënyrë të qartë, në veçanti sa i përket vendimeve të dhëna në procedurat sipas ankesës kushtetuese. Kjo është kështu sepse ky lloj i procedurave përbën një pjesë bukur të madhe të punës së gjykatave kushtetuese. Jo vetëm kaq! Vendimet e dhëna në procedurat sipas ankesave kushtetuese kanë një strukturë argumentuese më të ndryshme se sa kur bëhet fjalë për vendimet e dhëna në kontrollin abstrakt të normës. Këtë e shënojmë më kujdes në këtë seksion.

Në fund, seksioni i katërt bën fjalë për zbatimin e vendimeve të gjykatave kushtetuese, si në Kosovë ashtu dhe jashtë saj, duke dhënë specifikat e ekzekutimit. Me këtë mbyllet pjesa diskutuese për të kaluar në seksionin e parafundit, ku jepen komentet dhe pyetjet për lexuesin me qëllim të provokimit të debateve dhe diskutimeve konstruktive rreth çështjeve kryesore të shtjelluara në këtë kapitull. Kjo pjesë ndihmon shumë lexuesin për të kuptuar esencën e krejt tekstit tonë këtu.

Nisur nga fakti se trajtimi ynë në këtë kapitull, njëjtë si në krejt kapitujt tjerë, është nga këndi krahasues, në seksionin e fundit jepet një literaturë shtesë për lexim, krejt me qëllim që lexuesit tonë t'i jepet një orientim sa më i gjerë rreth gjendjes aktuale të literaturës në gjyqësinë kushtetuese që ka të bëjë me vendimet e saj, natyrën juridike dhe veçoritë e tyre karakteristike.

15. 1. Sqarime paraprake: *Erga Omnes* si efekt i përgjithshëm, *Inter Partes* si efekt i kufizuar dhe dallimet e tyre me *Res Judictata* si efekt specifik i vendimit

Neni 116.1 ["Efekti Juridik i Vendimeve"] i Kushtetutës përcakton si vijon:

"[…] Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës."

Kjo dispozitë e bën të qartë se forca juridikisht e detyrueshme e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nuk përcaktohet ekskluzivisht vetëm nga cilësia e tyre përmbajtësore e brendshme dhe procedura në të cilën janë dhënë. Mbi të gjitha dhe në rend të parë, ajo forcë përcaktohet nga pozita dhe roli që ka Gjykata si organ shtetëror në hierarkinë e institucioneve kushtetuese me juridiksion të qartë. Kjo është kështu në të gjitha vendet që kanë *modelin* e llojit **kelsenian/evropian të gjyqësisë kushtetuese, pa asnjë përjashtim.**

Neni 116.1 si më sipër flet për konceptin e fuqisë së përgjithshme (erga omnes) të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, si akte juridike të një rëndësie superiore (sipërore) në kuadër të akteve juridike nacionale. Me këtë koncept nënkuptohet, thënë me fjalë të tjera, se vendimet e kësaj Gjykate kanë fuqi superiore (më të madhe) juridike se çdo akt tjetër juridik (individual dhe i përgjithshëm) i çdo organi tjetër shtetëror apo autoriteti tjetër publik. Nga kjo dispozitë ravijëzohen tri segmente që shpërfaqen në raport me krejt ambientin e jashtëm në cilin operojnë vendimet pas miratimit të tyre:

- e para, i gjithë gjyqësori, të gjitha organet kushtetuese, individët dhe institucionet e tjera të Kosovës janë të detyruar që t'**i respektojnë** *vendimet e Gjykatës Kushtetuese;*
- e dyta, i gjithë gjyqësori, të gjitha organet kushtetuese, individët dhe institucionet e tjera të Kosovës janë të detyruar që t'i **përshtatin sjelljet e tyre** konform vendimeve të Gjykatës Kushtetuese; dhe, së fundi
- e treta, i gjithë gjyqësori, të gjitha organet kushtetuese, individët dhe institucionet e tjera të Kosovës janë të detyruar që të **zbatojnë vendimet** e Gjykatës Kushtetuese brenda kompetencave të tyre të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligje.

Në Kushtetutë, njëjtë si në shumicën e vendeve evropiane që modelon sipas sistemit evropian/kelsenian, por dhe në vendet tjera ku kontrolli kushtetues i normave dhe i veprimit apo mosveprimit të autoriteteve shtetërore/publike është thellë i rrënjosur, të vetmet produkte që përmenden në mënyrë specifike si të detyrueshme për pushtetin gjyqësor, organet dhe personat tjerë janë produktet e Gjykatës Kushtetuese. Kjo nuk është kështu kur bëhet fjalë për vendimet e gjyqësorit të rregullt apo për vendimet individuale të organeve të tjera të pushtetit.

Ky efekt i përgjithshëm që detyron çdokënd në tri segmentet (dimensionet) e shpërfaqura si më sipër (respektimi i vendimeve, përshtatja e sjelljeve kundrejt kërkesave të vendimeve dhe zbatimi i tyre në praktikë) dallon rrënjësisht nga efektet juridike që prodhojnë vendimet kushtetuese konkrete: efekti i përgjithshëm **(erga omnes)** ka të bëj me respektin që duhet ta tregojnë të gjithë, **erga omnes***, n*daj vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, nga i cili derivohen edhe dy segmentet të tjera si më sipër (përshtatja e sjelljeve konform me vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe zbatimi i tyre konkret nga ana e organeve që kanë kompetencë kushtetues dhe ligjore për një gjë të tillë). Kjo e bën mjaft të qartë se efekti i përgjithshëm **(erga omnes)** nuk duhet të ngatërrohet me efektin res judicata, i cili i vetmi përbën objektin e ekzekutimit, në ndërkohë që efekti i përgjithshëm **(erga omnes)** nuk është i krijuar për ekzekutim sepse i tillë nuk është vetëpërveti nisur nga fakti që konceptualisht nuk ka fund dhe as substancë të përcaktuar saktësisht. Kësaj çështjeje, përkatësisht këtij dallimi i rikthehemi sërish në seksionin e fundit të këtij kapitulli.

Sa i përket efekteve të tjera konkrete dhe specifike të vendimeve të kësaj Gjykate, ndërkaq, vlen të theksohet se ato kanë të bëjnë me natyrën juridike të vendimeve të saj. Kjo natyrë juridike nuk përcaktohet nga asgjë tjetër më shumë se nga cilësia e tyre e brendshme dhe efekti konkret që prodhojnë në marrëdhëniet kushtetuese, si pjesë e marrëdhënieve njerëzore: në disa raste, vendimet në fjalë kanë natyrë juridike **konstituive** (transformuese), siç është rasti me vendimet meritore në procedurat e kontrollit abstrakt të normës, në të tjerat raste ato kanë karakter **deklarativ***,* siç është rasti me vendimet mbi ankesat kushtetuese, kurse në disa raste të tjera ato mund të kenë edhe efekte **vërtetuese***,* siç është rasti me vendimet e konfliktit për kompetencës, për kontrollin e kushtetutshmërisë së shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme dhe kështu me radhë.

Cilësia e brendshme dhe procedura në të cilën janë vendimet, sikundër mund të vërehet, kanë relevancë vetëm sa i përket efekteve juridike që lloji i caktuar i vendimeve prodhon për palët, Gjykatën, palët e treta dhe për ambientin e jashtëm lidhur me një çështjeje konkrete kushtetuese. Shikuar në këtë kuptim, cilësia e brendshme e një aktvendimi kushtetues nuk mund të ketë efekte të tjera pos atyre brenda vetë procedurës në të cilën është dhënë dhe vetëm sa i përket palëve në procedurë dhe interesave të tyre. Kjo është kështu në veçanti kur bëhet fjalë për vendimet e dhëna në procedurën sipas ankesës kushtetuese nga neni 113.7 ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] i Kushtetutës. Në rastet kur këto vendime kanë natyrë juridike të vendimeve meritore (aktgjykimeve), atëherë gjendja ndryshon: efekti i tyre, sa i përket pjesës operative (dispozitivit), është **inter partes***,* njëjtë si në rastin e aktvendimeve, kurse pjesa arsyetuese e tij përbën një **res interpretata**. Me këtë term nënkuptohet efekti juridik specifik sipas të cilit çdo organ tjetër shtetëror, përveç **Gjykatës Kushtetuese***,* detyrohet që të ndjek arsyetimin e dhënë lidhur me pjesën operative (dispozitivin) e aktgjykimit me të cilin vendoset në një rast apo mosmarrëveshje konkrete kushtetuese. Vetë dispozitivi (pjesa operative), ndërkaq, ka efekt **res judicata***,* por me efekt të kufizuar ekskluzivisht për rastin dhe mosmarrëveshjen konkrete. Kjo është kështu sepse vendimet meritore të gjykatave kushtetuese, përfshirë **Kosovën***,* që vendosin meritoritsht lidhur me ankesën kushtetuese kanë karakter deklarativ, përkatësisht deklarojnë shkeljen e lirive dhe të drejtave kushtetuese, duke mos u zëvendësuar (substituar) në vend të gjyqësorit

apo organit tjetër shtetëror që ka kryer shkeljen e konstatuar nga gjykata kushtetuese. Për këtë arsye është gabim i madh profesional kur aktgjykimet e **Gjykatës Kushtetuese**, në pjesën operative konstatojnë se ky ose ai vendim i **Gjykatës Supreme të Kosovës** (ose i ndonjë organi tjetër kosovar shtetëror) është (apo nuk është) në pajtim me këtë ose atë nen të Kushtetutës.[1]

Është gabim sepse, në procedurat sipas ankesave individuale, objekt i çështjes është nëse një vendim/veprim (ose mosveprim) i një organi shtetëror ka cenuar liritë dhe të drejtat kushtetuese, jo vetëm të shtetasve të Kosovës, por edhe të secilit individ që gjendet nën juridiksionin e Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur. Objekt i kontrollit kushtetues, ndërkaq, është akti /veprimi (ose mosveprimi) i një organi publik të Kosovës. Kjo praktikë e çuditshme, obskure gjithsesi, ka nisur të praktikohet pas vitit 2015, për t'u intensifikuar viteve të fundit. Është obskure për faktin e thjeshtë se mandati primar (parësor) i gjykatave kushtetuese të modelit **evropian/kelsenian** që nga lindja e tyre e deri më sot është vendosja nëse ligjet dhe aktet tjera më të ulëta se ligji janë në përputhje me kushtetutën. Kjo është fizionomia themelore e gjyqësisë kushtetuese **evropiane/kelseniane**, e cila reflektohet qartë në secilën kushtetutë nacionale, përfshirë Kosovën. Kjo fizionomi sanksionohet në dispozitën e nenit 112.1 [Gjykata Kushtetuese: Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës përcakton si vijon:[2]

*"*Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën".

Nga ky definim i gjyqësisë kushtetuese kosovare, që është standard në të gjitha vendet që përqafojnë **modelin evropian/kelsenian**, dy gjëra dalin në spikamë: koncepti i interpretimit kushtetues (**constitutional interpretation**) dhe koncepti i kontrolli kushtetues (**constitutional** apo **judicial review**). Këtë dallim nuk e bën kushtetuta, por praktika e gjyqësisë kushtetuese. Me **interpretim kushtetues** nënkuptohet procesi i ndërtimit apo krijimit të kuptimit dhe i sqarimit të kushtetutës nacionale (nëse ekziston si tekst i shkruar), i teksteve të tjera kushtetuese dhe i normave e parimeve të tjera të pashkruara që kanë veçori kushtetuese; **kontrolli kushtetues** apo **kontrolli gjyqësor i kushtetutshmërisë**, ndërkaq, quhet procesi në të cilin vlerësohet nëse **sjellja e një akteri kushtetues** është në pajtim me kushtetutën, me tekstet e tjera apo parimet që kanë cilësi kushtetuese.[3]

---

1 *Rasti KI 150/16. Aktgjykim. Parashtrues: Mark Frrok Gjokaj Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, CLM. nr. 11/2016, të 13 shtatorit 2016*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 31 dhjetor 2018. Nr. ref.: AGJ 1314/18:
"[…] **PËR KËTO ARSYE,** Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113 (7) dhe 116 (1) të Kushtetutës, nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullat 56 (1), 63 (1) (5) dhe 74 (1) të Rregullores së punës, më 19 dhjetor 2018 : **VENDOS:** […] **II**. TË KONSTATOJE me shumice votash se Aktvendimi [CLM. nr. 11/2016] i 13 shtatorit 2016 i Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Aktvendimi [AC.nr. 1579/2015] i 4 prillit 2016 i Gjykatës së Apelit të Kosovës, është në pajtueshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejte dhe të Paanshëm] të Kushtetutës. […]"; dhe
Rasti KI 48/18. Aktgjykim. Parashtrues: Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit AA. nr. 52/2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të 25 nëntorit 2017 dhe Aktgjykimit A.A. U. ZH. nr. 62/2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të 7 dhjetorit 2017. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtinë, më 4 shkurt 2019. Nr. ref.: AGJ 1322/19:
"[…] **PËR KËTO ARSYE,** Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit dhe me rregullin 59 (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 23 janar 2019, njëzëri: **VENDOS: II.** TE KONSTATOJE se Aktgjykimi A.A. U.ZH. nr. 62/2017, i 7 dhjetorit 2017, i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, është në përputhshmëri me nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe në përputhshmëri me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; **III.** TË KONSTATOJË se Aktvendimi A.A. nr. 52/2017, i 25 nëntorit 2017, i Gjykatës Supreme te Republikës së Kosovës, është në përputhshmëri me nenin 54 te Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe në përputhshmëri me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".

2 Fizionominë e **Gjykatës Kushtetuese** nga aspekti komparativ e kemi trajtuar gjerësisht në seksionin 11.1 të kapitullit të njëmbdhjetë të këtij libri.

3 Maartje de Visser, *Constitutional Review in Europe: A Comparative Analysis* (Hart Publishing: Oxford and Portland, Oregon, 2015 fq. 2.

T'i kthehemi tani çështjes ku ngelëm, te ankesa kushtetuese dhe kontesti kosovar i saj në lidhje me **res interpretationis**. Në sferën e **res interpretata** nuk ka rëndësi lloji i **ankesës kushtetuese,** e plotë, jo e plotë, apo gjysmë e plotë:[4] ajo që ka rëndësi dhe që çon peshë është shkelja apo cenimi i lirive dhe të drejtave kushtetuese, pa marrë parasysh bazën e shkeljes apo cenimit kushtetues. Në këto raste, gjykata kushtetuese vetëm deklaron shkeljen kushtetuese duke e kthyer çështjen në rigjykim apo rivendosje te organi kompetent sipas kushtetutës dhe ligjit. Kështu është standardi gjithandej në vendet që kultivojnë ankesë kushtetuese dhe i takojnë modelit evropian/kelsenian të gjyqësisë kushtetuese.

Shënojmë këtu se **res interpretata** nuk vlen si detyrim për gjykatën kushtetuese, e cila në çdo moment mund ta ndryshoj precedentin e vet. Ky detyrim vlen çdoherë për gjyqësorin dhe organet tjera që duhet t'i zbatojnë vendimet e saj. Kjo është kështu edhe gjetiu në vendet e demokracive kushtetuese, në dy anët e **Atlantikut,** sepse në vendimmarrjen lidhur me të drejtat e liritë kushtetuese nuk ka një instancë tjetër më të lartë se gjykata kushtetuese, ose gjykata tjetër e barasvlefshme me të që ushtron juridiksion kushtetues, që mund të sfidojë autenticitetin dhe vërtetësinë e asaj që është thënë aty. Kjo është esenca e kuptimit **erga omnes**: fuqia e përgjithshme detyruese (erga omnes) e vendimeve të gjykatave kushtetuese buron nga fakti se vetëm gjykatat kushtetuese kanë fjalën e fundit dhe monopolin e interpretimit përfundimtar apo autoritativ të kushtetutës nacionale, të normave dhe parimeve të saj.

Sa i përket **res interpretata**, në **Kosovë** ekziston një përjashtim, i cili buron nga neni 53 ["Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut"] i Kushtetutës. Kjo, megjithatë, nuk ndryshon esencën e detyrimit të përgjithshëm **(erga omnes)** nga neni 116.1 i Kushtetutës, i cili vlen për të gjithë, pos për vetë prodhuesin e produktit - Gjykatën Kushtetuese. Fuqia e përgjithshme detyruese nuk e detyron Gjykatën Kushtetuese, qoftë gjatë kohës sa akoma është në fuqi vendimi i saj me vlerë precedenti apo më vonë, në momentin që ai ndryshon. Në rastin e fundit, detyrimi i përgjithshëm **(erga omnes)** ndryshon dhe shtrihet (kalon) te vendimi i ri, i cili bëhet precedent nëse kalon disa teste për ndërtimin e precedentëve. Ai nuk ka fuqi të përgjithshme detyruese për Gjykatën Kushtetuese, por vetëm subjektet e tjerë të cilëve iu referohet neni 116.1 i Kushtetutës.[5]

Të sqarojmë tani se në çfarë konsiston dallimi i Kosovës me vendet tjera në sferën e **res interpretata**: në rastin e Kosovës, **res interpretata** ankorohet në nenin e sipër cekur 53 të Kushtetutës, pra jo në precedentet e saj të mëparshme por në precedentet e farkëtuara në **Gjykatën e Strasburgut.** Kjo nënkupton se në rastet e interpretimit të lirive dhe të drejtave të njeriut të garantuara me **KEDNJ**, Gjykata Kushtetuese detyrohet të ndjek interpretimin e dhënë nga **Gjykata e Strasburgut**. Ky nuk është rasti me gjykatat e tjera kushtetuese, të cilat mund ta përdorin si res interpretata të drejtën e huaj vetëm nëse një gjë të tillë vlerësohet si me dobi për zhvillimin e konstituticionalizmi të tyre apo për shkak se e drejta përkatëse e huaj është inkorporuar (internalizuar) në sistemin e brendshëm kushtetuese në mënyrën të vlefshme kushtetuese.[6] Në këtë drejtim, **Kosova**, megjithatë, nuk është vetëm: **Bosnje-Hercegovina** përfaqëson një përjashtim sepse, njëjtë si në Kosovë, **KEDNJ** paraqet një normë pozitive kushtetuese që duhet të zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në tërë territorin e këtij vendi.

Në vijim të diskutimit si më sipër lidhur me vendimet meritore, gjendja ndryshon kur bëhet fjalë për vendimet meritore që merren në procedurat e **kontrollit abstrakt** të normës juridike:

---

4 Cf. më shumë për **ankesën kushtetuese** dhe llojet e saj në seksionin 113.7 të kapitullit njëmbëdhjetë të librit.

5 Këtë e kemi diskutuar gjerësisht në kapitullin trembëdhjetë të librit, kur kemi bërë fjalë për precedentet.

6 Cf. më shumë për këtë në punimin e shkëlqyer Janneke Gerards, "The European Court of Human Rights". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* (Cambridge University Press: Cambridge, 2017) fq. 237-276 (ku autori shpjegon rolin e **Gjykatës së Strasburgut** si një lloj gjykate kushtetuese **vis-avis** gjykatave nacionale të shkallës së fundit që vendosin për liritë dhe të drejtat e njeriut të garantuara me **KEDNJ**, si dhe shkallën dhe caqet e detyrimit të tyre për të ndjekur interpretimin e dhënë nga **Gjykata e Strasburgut**).

në këto raste vendimi ka **efekt juridik konstituiv (transformues)**, përkatësisht ndryshon aktin juridik që ka qenë objekt i kontrollit kushtetues. Ky **efekt konstitutiv** shpërfaqet në forma të ndryshme: dikur, çdo vendim meritor i dhënë në procedurën e kontrollit abstrakt të normës juridike ka rezultuar në anulimin e normës ose të tërë tekstit në të cilin është gjetur norma e tillë (nëse teksti si tërësi ka humbur kuptimin për shkak të anulimit të normave të tij kryesore)[7]. Kjo nuk është kështu aktualisht nisur nga fakti se ekzistojnë modalitete të tjera krahas **ligjvënies negative**: siç do të shtjellohet në seksionin në vijim, gjykatat kushtetuese jo rrallë ushtrojnë **ligjvënie pozitive, kushtetutshmëri të përkohshme, shtyjnë afatin për ndreqjen e jokushtetutshmërisë së evidentuar me vendim meritor** dhe kështu me radhë. Në vend të anulimit, në këto raste vjen deri te pezullimi i zbatimit, pavlefshmëria, shfuqizimi dhe kështu me radhë i normës së sfiduar apo i tekstit që përmban normën e tillë, duke menaxhuar në ndërkohë efektet e këtij verdikti jo-anulues.

Përkundër këtyre sqarimeve, nuk është e lehtë gjetja dallimit në mes të fuqisë së detyrueshme erga omnes të vendimeve të gjykatave kushtetuese dhe **efekteve juridike të vendimeve të këtyre gjykatave të** dhëna në rastet konkrete brenda kompetencave të tyre kushtetuese: e para ka të bëjë me peshën që ka vendimi në hierarkinë shtetërore të vendimeve, të cilën ia njeh rendi konkret objektiv juridiko-kushtetues, kurse e dyti i referohet pasojave që prodhon vendimi konkret për palët në procedurë, palët e treta, gjykatën dhe ambientin përreth. Në rastin e parë, fuqi të detyrueshme kanë vendimet marrë në tërësinë e tyre, kurse në të dytin duhet të shikohet pjesa arsyetuese dhe ajo e dispozitivit të vendimit dhe më pastaj të gjykohet se cila pjesë dhe në cilën masë është e detyrueshme për palët, personat e tretë dhe ambientin e jashtëm dhe, në fund, për vetë gjykatën përkatëse kushtetuese. E shprehur me fjalë të tjera, veçoria e fuqisë detyruese **erga omnes** buron nga rendi objektiv juridiko-kushtetues, i cili përcakton fuqinë e secilit akt juridik në kuadër të hierarkisë së përgjithshme të tyre, kurse efektet juridike të vendimeve tregojnë për të drejtat dhe detyrimet e palëve në procedurë, të personave të tretë, gjykatës dhe ambientit të jashtëm.

Ngatërrimi i fuqisë së detyrueshme të vendimeve **(erga omnes)** me **efektet juridike**, që shprehen në formën **res judicta, rest interpretata dhe inter partes**, buron nga fakti i moskuptimit të natyrës juridike (deklarative, konstituive dhe vërtetuese) dhe llojeve të vendimeve të gjykatave kushtetuese (meritore dhe jo-meritore). Fjalën e kemi për vendimet e dhëna në procedurat për kontrollin abstrakt të normës, ku disa autor fusnin në një thes fuqinë e detyrueshme në kuptim të nenit 116.1 të Kushtetutës **(erga omnes)** *d*he efektet standarde juridike të vendimeve apo efektet **res judicata, res interpretata** dhe **inter partes.**[8] Si një efekt shtesë futet edhe i a.q. **efekti i vendimit që ka fuqi të njëjtë me ligjin**, i cili, në fakt, përbën një kategori të efektit deri më tani jo fort të njohur në teorinë dhe praktikën e gjyqë-

---

[7] Kjo praktikë në gjyqësinë kushtetuese kosovare përbën një standard që nuk ka ndryshuar substancialisht që nga themelimi i **Gjykatës Kushtetuese**. Si rast i fundit që konfirmon këtë është aktgjykimi që shpalli të pavlefshëm një ligj që mandatonte një grup njerëzisht për të përfaqësuar Kosovën në dialogun me **Serbinë**. **Gjykata Kushtetuese** në këtë rast, me plot të drejtë konstatoi se ky trup ishte uzurpator i kompetencave të ekzekutivit kosovar, që i vetmi ishte i autorizuar për të propozuar dhe zbatuar politikën e jashtme të Kosovës dhe ky autorizim, për pasojë nuk mund të delegohej të trupat tjerë. Kur shpalli të pavlefshëm dispozitat kryesore të ligjit që krijonte këtë trup jo-kushtetues, meqë, inter alia, cenonte parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, Gjykata Kushtetuese konstatoi se marrë si tërësi ligji nuk kishte fuqi juridike dhe, për pasojë, nuk mund të ishte pjesë e rendit juridiko-kushtetues të Kosovës. *Rasti K0 43/19. Aktgjykim. Parashtrues: Albulena Haxhiu, Driton Selmanaj dhe tridhjetë deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë se Ligjit nr. o6/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtinë, me 27 qershor 2019. Nr. ref.: 1387/19. Pika III e pjesës operative (dispozitivit).

[8] Ky ngatërrim, në kontekstin kosovar, vjen me sa duket si rezultat i redaktimit gabim të dispozitës së nenit 116.1 të Kushtetutës, përkatësisht të titullit të këtij neni, që flet për **efektet juridike të vendimeve**, në vend se të kishte pasur titullin **fuqia e detyrueshme e vendimeve**, nisur nga fakti se çështja e normimit të efekteve të vendimeve të Gjykatës Kushtetues bie në kompetencë të **Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës**, siç është rasti, në fakt, edhe me pjesën dërrmuese të gjykatave kushtetuese në **Evropë**.

sisë kushtetuese.[9] Në teori dhe në praktikë, zakonisht, krahas efekteve të sipërcekura klasike **(res judicta** dhe **inter partes)**, janë ndërtuar edhe disa efekte të tjera. Këtu e kemi parasysh në rend të parë efektin **res interpretata**, të cilin e diskutuam më sipër.

Përveç këtij, ekzistojnë edhe disa efekte të reja dhe inovative, të cilat i diskutojmë në seksionin në vijim, dhe që kanë lindur si rezultat i pasurimit të tipologjisë së vendimeve të gjykatave kushtetuese. Ky pasurim ka ndodhur në një numër të madh të vendeve që kanë gjykata të ndara kushtetuese të **modelit evropian/kelsenian**, me qëllim të akomodimit të nuancave të verdiktit standard me të cilin deklarohet jo kushtetuese norma juridike apo akti i përgjithshëm si tërësi. Tipologjia e pasuruar në këto vende mund të cilësohet edhe si inovacion, nisur nga fakti se ka lindur si rezultat i faktit që, në këto vende, ligjet mbi organizimin dhe punën e gjykatave kushtetuese zakonisht nuk kanë përcaktuar llojet e vendimeve në kuptimin formal përtej standardit klasik të dihotomisë së **vendimit që gjenë se norma apo ligji janë jo-kushtetues** vs. **kushtetues**, përkatësisht të dihotimisë së vendimit që gjen se norma apo ligji i kontestuar nuk është në pajtim me kushtetutën vs. **është në pajtim me kushtetutën.** Në dy llojet e vendimeve, në të njëjtin dispozitiv, ngërthehet vendimi për anulim (pavlefshmëri) vs. konfirmim të normës (ligjit të kontestuar).

Këtë tipologji të verdikteve të gjykatave kushtetuese e ka pasuruar praktika e gjatë e gjykatave kushtetuese ndër vite, jo ligjet mbi organizimin dhe punën e gjykatave kushtetuese. Këtë e thamë më sipër. Si rezultat i këtij pasurimi, sot ekzistojnë alternativa tjera përveç alternativës standarde si më sipër të anulimit të normës apo ligjit të shpallur si jokushtetues (apo që është gjetur si jo në pajtim me kushtetutën). Këto alternativa kanë forma të ndryshme të manifestimit, që nga doktrina përmblidhen, në terma të përgjithshëm, për si vijon:[10]

- e para, aktgjykimi mund të shpall jokushtetues/kundërkushtetues një normë apo ligj, por **nuk bën anulimin e tyre**;
- e dyta, aktgjykimi mund të shpallë jokushtetues/kundërkushtetues një normë apo ligj, **por e shtyn anulimin e tyre**;
- e treta, aktgjykimi mund të përcaktojë që norma apo ligji është jokushtetues/kundërkushtetues, por i jep ligjvënësit një afat të caktuar për ndreqjen e problemit, përkatësisht defektit kushtetues;
- e katërta, aktgjykimi mund të ketë natyrë interpretative ashtu që deklaron se norma apo ligji nuk janë jokushtetues/kundërkushteues por vetëm nëse interpretohen në mënyrën e përcaktuar me aktgjykimin e njëjtë;
- e pesta, aktgjykimi mund të ketë natyrë interpretative ashtu që deklaron se norma apo ligji nuk janë jokushtetues/kundërkushteues, por **vetëm nëse nuk interpretohen në një mënyrë të përcaktuar me aktgjykimin e njëjtë***;*

---

[9] Këtë shprehje për herë të parë e ka përdorur në doktrinë **Helmut Steinberger**, në punimin e tij "Decisions of the constitutional court and their effects", botuar nga Venice Commission (ed), *Role of the Constitutional Court in the Consolidation of the Rule of Law* (Science and technique of democracy No.10, 1994) fq. 79-80, fusnotat 59-62 (ku autori i referohet sistemeve kushtetuese në **Greqi, Lituani** dhe **Gjerman**i, si sisteme që njohin efektin e forcës së ligjit; në fakt, sipas autorit, ky koncept si duket ka origjinë gjermane, gjë që shihet edhe në dispozitat mjaft të bollshme kushtetuese për këtë materie; sipas këtij koncepti, vendimi i gjykatës kushtetuese krijon dhe shuan të drejta e detyrime për subjektet e së drejtës që janë nën juridiksionin e dhënësit të vendimit të tillë; ky efekt lidh edhe vetë dhënësin, gjykatën përkatëse kushtetuese). Në internet: https://www.venice.coe.int/webforms/ documents/default.aspx? pdffile= CDL-STD%281994%29010-e (shikuar në mars 2018); Cf. po ashtu edhe Ms Eliška Wagnerova, "The Effects of the Decisions of the Constitutional Court in Relation to Other Jurisdictions". European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Conference on the Role of the Constitutional court in the Maintenance of the Stability and Development of the Constitution*. Strasbourg, 19 February 2004. CDL – JU (2004) 017. Në internet: https://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-JU(2004)017-e (shikuar në mars 2018); Më shumë për këtë çështje në kontekstin Kosovar, cf. Visar Morina, "*The Legal Prospective Force of Constitutional Courts Decisions: Reflections from the Constitutional Jurisprudence of Kosovo and Beyond" Nottingham Law Journal Vol. 25 (2016)* fq. 19-21.

[10] Marian Ahumada Ruiz, "The Spanish Constitutional Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 604-640 në fq. 613-615.

- e gjashta, aktgjykimi mund të shpallë si jokushtetues/kundërkushtetues disa interpretime të normës apo ligjit të kontestuar, **por jo edhe vetë tekstin e tyre të shkruar**; dhe, së fundi,
- e shtata, aktgjykimi mund të thotë se norma apo ligji i kontestuar, përkundër faktit që kanë qenë kushtetues në kohën e sfidimit të tyre në gjykatë, ligjvënësi duhet t'i harmonizojë ato sepse **me kalimin e kohës mund të bëhen jokushtetuese/ kundërkushtetuese.**

Në secilën nga këto lloje të vendimeve të gjykatave kushtetuese prodhohen efekte të ndryshme juridike, të cilat nuk i përcakton kushtetuta dhe ligji sepse, si të tilla, janë variante të vendimmarrjes të krijuara nga përvoja disa vjeçare e gjykatave kushtetuese. Fuqia detyruese e tyre, ndërkaq, ngelet e njëjtë - **erga omnes**. Kjo do të thotë se çdokush duhet t'i ketë parasysh tri situatat dhe dimensionet e sipërcekura të kësaj fuqie të përgjithshme detyruese.

Sa i përket efekteve konkrete të vendimeve të gjykatave kushtetuese, krahas atyre që u diskutuan më sipër, teoria dhe praktika njeh edhe disa efekte të tjera që duhen përmendur këtu. E kemi fjalën për efektet e vendimeve meritore që anulojnë normën apo ligjin e sfiduar, të cilat mund të jenë qoftë me efekt **ex nunc** (tani e tutje) ose **ex tunc** (tani e prapa). Në ndërkohë që efekti **ex nunc** më shumë i shkon natyrës së vendimeve që kanë për objekt kontrollin abstrakt të normave juridike, për shkak të parimit të sigurisë juridike, efekti ex tunc më shumë ka kuptim te vendimet që lidhen me liritë dhe të drejtat e njeriut, për shkak të sanimit të pasojave të shkaktuara nga cenimi i tyre me vendimet e autoriteteve shtetërore/publike.

Ngatërrimi i fuqisë së përgjithshme detyruese **(erga omnes)** me efektet juridike të vendimeve që lidhen me **cilësitë e tyre konkrete të brendshme**, të përshkruara si më sipër, është i gabuar. E thënë ndryshe, është gabim qasja që barazon fuqinë juridikisht të detyrueshme **per constitutionem** të vendimeve kushtetuese, që buron nga statusi i tyre juridik-kushtetues si akte më të larta në kuadër të hierarkisë së akteve juridike dhe burimeve të së drejtës në përgjithësi, me efektet juridike që i prodhon një vendim individual i dhënë lidhur me një rast dhe mosmarrëveshje konkrete. Është gabim sepse neni 116.1 i Kushtetutës normon vendin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të dhëna në ushtrim të juridiksionit të saj kushtetues. Në kuptim të hierarkisë juridiksionale dhe institucionale të cilin e gëzon Gjykata Kushtetuese, dispozita e nenit 116.1 të Kushtetutës flet për vendimet e Gjykatës Kushtetuese si për urdhra që kanë fuqi më të lartë kushtetuese në kuadër të hierarkisë së akteve juridike individuale të nxjerra me rastin e vendosjes për një rast apo mosmarrëveshje konkrete kushtetuese.

Dispozita si më sipër e nenit 116.1 e Kushtetutës përcakton në mënyrë të qartë natyrën juridike të vendimeve individuale të Gjykatës Kushtetuese të marra në vijim të ekzekutimit të juridiksionit të saj kushtetues nga nenit 113 i Kushtetutës. Kjo ka pasoja në hierarkinë e burimeve të së drejtës kushtetuese kosovare. Një gjë e tillë rrjedh nga fakti se kjo natyrë juridike ka të bëjë me hierarkinë e akteve juridike, e cila përcaktohet gjithnjë duke u bazuar në parametrat juridiksionalë dhe institucionalë në nivel vendi. E thënë me fjalë të tjera, kjo dispozitë çdoherë i referohet ekskluzivisht vetëm vendimeve të dhëna në vijim të ushtrimit të juridiksionit kushtetues nga neni 113 i Kushtetutës, duke mos pasur të bëjë asnjëherë me vendimet e dhëna në rastet apo mosmarrëveshjet e natyrës administrative. Këto vendime, për aq sa prekin liritë dhe të drejtat e njeriut, i nënshtrohen juridiksionit administrativ dhe juridiksionit gjyqësor që merret me kontrollin e ligjshmërisë së akteve administrative, si dhe rregullave përkatëse lidhur me shërbimin civil kosovar.

Efektet juridike të vendimeve **qua** vendime individuale të dhëna me rastin e vendosjes për një rast apo mosmarrëveshje konkrete kushtetuese, ndërkaq, përbëjnë një kategori tjetër kushtetuese dhe ligjore dhe kanë të bëjnë me përgjigjen përfundimtare që ato japin lidhur

me kërkesën që ka qenë objekt i vendimit kushtetues, duke sanksionuar kështu në mënyrë konkluzive një marrëdhënie konkrete kushtetuese në mes të palëve në procedurë dhe subjekteve të tjerë të së drejtës. Si të tilla, vendimet individuale të dhëna në vijim të zgjidhjes së një rasti apo mosmarrëveshje kushtetuese nga neni 113 i Kushtetutës paraqesin veprimtarinë themelore të Gjykatës Kushtetuese, pa marrë parasysh se cili është burimi i së drejtës apo parametri kushtetues që ka shërbyer si bazë juridike-materiale për vendosjen e rastit.

Për të qenë edhe më i saktë, me fjalë të tjera, në vijim si më sipër, dispozita e nenit 116.1 të Kushtetutës bën fjalë për vendimet që kanë për objekt vlerësimin e kushtetutshmërisë së normës juridike (kushtetuese, ligjore dhe tjetër) dhe të aktit individual juridik të një autoriteti publik, si dhe për vendin e tyre në hierarkinë e burimeve të së drejtës në Kosovë. Kjo nuk ka të bëj me kërkesat **(petitumet)** e palëve në procedurë të paraqitura nga vetë palët: kjo materie shpjegohet jo përmes nenit 116.1 të Kushtetutës, por përmes koncepteve të tjera, siç janë **res judicata** dhe efektet e tjera relacionale ndërmjet palëve në procedurë, **inter partes**, dhe kundrejt menaxhimit të efekteve konkrete kohore të pasojave juridike që prodhon një vendim konkret, efektet **ex nunc** (për të ardhmen) dhe efektet ex tunc (për të kaluarën). Këto koncepte kanë të bëjnë me statusin juridiko-kushtetues, përkatësisht me sanksionimin që ka fituar me vendim kushtetues një marrëdhënie konkrete, e cila ka marrë përgjigje përfundimtare nga Gjykata Kushtetuese. Fuqia e përgjithshme detyruese e vendimeve, **erga omnes,** e parë në dritën e këtyre koncepteve si më sipër, përbën cilësinë e vendimeve të gjykatave kushtetuese që garantohet nga kushtetutat nacionale, kurse efektet konkrete juridike si më sipër **(res judicata, inter partes, ex nunc, ex tunc)** kanë të bëjnë me cilësinë e vendimeve konkrete kushtetuese dhe verdiktit të tyre që zbulon kuptimin e një norme konkrete kushtetuese që ka shërbyer si bazë juridike për sanksionim të marrëdhënies konkrete juridik-kushtetuese që përfshihet me vendim.

Nëse një **res judicta** do të ketë efekt prej precedenti varet nga shumë faktorë, në rend të parë nga efektet jurdike të vetë **res judicata**, gjë që është krejtësisht tjetër nga fuqia e përgjithshme detyruese **(erga omnes)** e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nga neni 116.1 i Kushtetutës: në ndërkohë që kjo e dyta ka të bëj me një përcaktim kushtetues që vendosë vendin hierarkik të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, të cilat interpretojnë Kushtetutën konform juridiksionit të Gjykatës nga neni 113 i Kushtetutës dhe fizionomisë së saj institucionale të përcaktuar me nenin 112.1 të Kushtetutës, e para, **res judicta**, parqet një vendim individual kushtetues, i dhënë për një rast apo mosmarrëveshje konkrete kushtetuese dhe, për pasojë, një ngrirje (incizim) të këtij rasti në kohë dhe hapësirë. Efektet e **res judicata** mund të shtrohen në marrëdhënien në mes të palëve, **inter partes.** Fuqia e përgjithshme detyruese **(erga omnes)** e vendimit që ka efekte **inter partes**, nuk buron nga cilësia e brendshme e verdiktit, por nga statusi i përgjithshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 113 lidhur me nenin 112.1 i Kushtetutës.

Kur rasti dhe mosmarrëveshja kushtetuese ka natyrë abstrakte, atëherë efektet juridike të vendimeve individuale të Gjykatës të dhëna në një rast konkret kanë karakter precedenti. Efekti prej precedenti i vendimeve kushtetuese nuk ka karakter absolut, ani se në hierarkinë juridike të vendimeve individuale dhe burimeve të së drejtës kushtetuese qëndron në nivel të njëjtë me vendimet që kanë efekte **inter partes**, për shkak se Gjykata Kushtetuese nuk është e lidhur me te dhe mund ta ndryshoj në çdo kohë. U mor vesh, ndryshimi i precedentit duhet të jetë i arsyeshëm dhe i arsyetuar, sepse ndryshe rritë pasigurinë juridike dhe dëmton rënd imazhin dhe legjitimitetit profesional të Gjykatës Kushtetuese.

Sa i përket efektit **res judicata** të një vendimi kushtetues, i marrë në çdo procedurë në kuptim të nenit 113 të Kushtetutës, vlen të theksohet se bëhet fjalë për një çështje krejtësisht të ndryshme nga koncepti **erga omnes** dhe efektit **stare decisis** i vendimeve. Ky ndryshim

është i natyrës rrënjësore sepse këtu bëhet fjalë për caqet caqet objektive dhe caqet subjektive të shtrirjes së efekteve të një çështje të gjykuar me vendim kushtetues (coftë ai meritor apo vendim jo meritor). Kështu, ta zëmë, e drejta për jetë mund të mbrohet nga Gjykata Kushtetuese me një vendim konkret të dhënë një rast individual, mirëpo i njëjti mund të mos shërbejë si precedent sepse narrativi i tij mund të mos përputhet fare me objektin dhe subjektin në rastin e dytë. Kështu, ta zëmë, në praktikën e Gjykatës Kushtetuese ekziston rasti i mirënjohur i **Diana Kastratit**, e vrarë nga ish-bashkëshorti i saj, për çka Gjykata ka konstatuar se barra e "fajit kushtetues" binte mbi gjyqësorin kosovar.[11] Në një rast tjetër në të ardhmen, e drejta për jetë mund të cenohet nga veprimet ose mosveprimet jokushtetuese të policisë ordinere, jo të organit gjyqësor (siç ka qenë rasti Diana Kastratit).

Efektet **res judicata** më shumë dhe kryesisht lidhen me ekzekutimin e vendimeve kushtetuese. Ato mund të jenë vendime të dhëna në çështjet që kanë të bëjnë me kontrollin abstrakt të normës (kushtetuese, ligjore dhe të normës tjetër), konfliktet për kompetencë dhe lidhur me çdo vendim të marrë në vijim të ushtrimit të kompetencave nga neni 113 i Kushtetutës. Kjo nënkupton se këtu bëhet fjalë për konceptin që lidhen me përcaktimin e caqeve subjektive dhe objektive të asaj që është sanksionuar me vendim të Gjykatës Kushtetuese dhe që në të ardhmen më nuk mund të jetë objekt i procedurës tjetër pranë saj. Si koncept, **res judicata** përbën njërin prej përbërësve kryesor të njërës prej të drejtave mjaft të rëndësishme kushtetuese, që njihet si parimi **Ne Bis In Idem** ("jo dy herë për të njëjtën çështje"). Ky parim, si një e drejtë kushtetuese, garantohet shprehimisht në sferën penale, mirëpo praktika dhe teoria pajtohen se ai ka shtrirje ndaj të gjitha procedurave gjyqësore dhe administrative, përfshirë këtu gjyqësinë kushtetuese.[12] Kjo e drejtë, në të njëjtën kohë, përbën një garancion kushtetues për subjektet e së drejtës që thotë se marrëdhëniet e konstatuara në mënyrë konkluzive në një procedurë të vlefshme juridike nuk mund të rihapen dhe ndryshohen më përveç rasteve shumë të rralla dhe qartë të përcaktuara më kushtetutë dhe ligje nacionale. Në marrëdhënie të tilla hyjnë edhe marrëdhëniet kushtetuese, të cilat mbulohen me vendimin **res judicata**, si në aspektin objektiv ashtu edhe në aspektin subjektiv. Kjo është kështu për shkak parimi kushtetues i sigurisë juridike, i cili, në të njëjtën kohë, paraqet përbërësin kryesor të parimit kushtetues të sundimit të ligjit, ka për synim arritjen e paqes dhe sigurisë juridike në mosmarrëveshjet e vendosura me vendim.[13] Këtë e synon realizimi i **res judicata**. Kjo nënkupton realizim i ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetues, si pjesë e parimit kushtetues të sigurisë juridike realizmit të plotë të lirive dhe të drejtave kushtetuese.

Zakonisht ligjet mbi gjykatat kushtetuese dhe rregulloret e brendshme normojnë efektet objektive, subjektive dhe kohore të **res judicata**. Kjo është kështu edhe në Kosovë: vetëm **RP** flet për **res judicata**

---

[11] *Rastin KI 41/12. Aktgjykim. Parashtrues: Gëzim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 26 shkurt 2013. Nr.ref.:AGJ 361/13. Bazuar në këtë vendim të **Gjykatës Kushtetuese**, gjyqësori i rregullt Kosovar ka vendosur në favor të familjes së viktimës, e cila ka paditur Shtetin e Kosovës për kompensim të dëmit jo-material si pasojë e cenimit të së drejtës kushtetuese për jetë dhe dhimbjeve të shkaktuara prindërve dhe familjes së viktimës. Cf. *Rasti C.nr.1209/13. Dokumenti nr. 00487072. Datë : 02.09.2019. Aktgjykim. Gjykata Themelore në Prishtinë*. **Republika e Kosovës**.

[12] Për zgjerimin në të drejtën kushtetuese, në veçanti në sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut, të zbatimit të parimit **ne bis in idem**, cf. më shumë në : Christine van den Wyngaert and Guy Stessens, "The International *Non Bis In Idem* Principle: Resolving Some of the Unanswered Questions" *The International and Comparative Law Quarterly* Vol. 48, No. 4 (Oct., 1999), fq. 779-804; Boris Andreev, "Russia and *Non Bis In Idem* Principle in International and Russian Law" *Revue internationale de droit penal* 2002/3 Vol. 73 (2002/3) fq. 1065 – 1070; John A.E. Vervaele, "*Ne Bis In Idem*: Towards a Transnational Constitutional Principle in the EU?" Utrecht Law Review Vol. 9 Issue 4 (September 2013) fq. 211 - 229.

[13] Për **res judicata** dhe zbatimin e gjerë të këtij parimi në sferat tjera të së drejtës përveç asaj penale, cf. më shumë në: T. N. Pant, "The Doctrine of 'Res Judicata' Its Import in Constitutional Law " *The Indian Journal of Political Science*, Vol. 25, No. 3/4 (July – September – Decmber, 1964) fq. 313-319; Xavier Groussot & Timo Minssen, "Res Judicata in the Court of Justice Case-Law: Balancing Legal Certainty with Legality?" *European Constitutional Law Review,* Vol. 3 Issue (November 2007) fq. 385–417; Angelo Dube and Musavengana Machaya, "The Doctrine of *Res Judicata* Revisited: Molaudzi v. the State" *Strategic Review for South Africa* Vol. 39 No. 2 (November 2017) fq. 78-93.

dhe atë në kontekst të lejueshmërisë së kërkesës për t'u shqyrtuar dhe gjykuar.[14] Mirëpo, për dallim nga fuqia e përgjithshme detyruese (**erga omnes**), e cila përcaktohet me kushtetutë e shumë më rrallë me ligjin për gjykatën kushtetuese, **res judicata** mund të mos përcaktohet fare me asnjërën prej tyre. Kjo, megjithatë, nuk ndryshona asgjë: edhe atëherë kur nuk normohet fare, **res judicata** paraqet një koncept të rëndësishëm kushtetues, i cili është pjesë e parimit kushtetuese të sundimit të ligjit. Ky parim kushtetues, në anën tjetër, ka për synim realizimin e paqes dhe sigurisë juridike në marrëdhëniet në mes të palëve.[15]

Fuqia e përgjithshme detyruese (**erga omnes**), nuk do të thotë së vendimi duhet të ekzekutohet nga të gjithë: çështja e ekzekutimit të vendimeve të gjykatave kushtetuese përbën vetëm njërin prej tre segmenteve (dimensioneve) të fuqisë detyruese (**erga omnes**). Këtë e diskutuam më sipër. Ajo që përbën esencën e fuqisë së përgjithshme detyruese (**erga omnes**) të vendimeve, ndërkaq, nuk lidhet me ekzekutueshmërinë apo jo të vendimeve por për cilësitë e tij kushtetuese, përkatësisht me superioritetin (epërsinë) e tyre të garantuar me kushtetutë nacionale kundrejt çdo akti tjetër juridik individual. Deri te ekzekutimi i vendimeve të gjykatave kushtetuese duhet të vije jo për shkak se kanë fuqi superiore (sipërore) më të lartë në vend, dhe kjo është esenca e efekteve të përgjithshme (**erga omnes**) të vendimeve, por sepse me to vendoset për një çështje të caktuar që ka natyrë kushtetuese në mënyrë përfundimtare.

Konceptit **res judicata** dhe marrëdhënies së tij me fuqinë e përgjithshme detyruese (**erga omnes**) të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese i kthehemi sërish në seksionin e fundit të këtij kapitulli. Të vazhdojmë tutje me konceptin tjetër, atë të **stare decisis**, gjithnjë në kontekstin e sqarimit të këtij dhe koncepteve të tjera për qëllimet e këtij kapitulli. E theksojmë këtë sepse në kapitullin trembëdhjetë kemi bërë fjalë për doktrinën **stare decisis** në një kontekst krejt tjetër, jo në kontekstin që ka të bëjë me natyrën juridike, efektet dhe me ekzekutimin e vendimeve të gjykatave kushtetuese në përgjithësi.

Efekti prej precedenti i vendimeve të gjyqësorit të rregullt dhe kushtetues, i njohur si stare decisis, gjithashtu nuk ka të bëjë me klauzolën nga neni 116.1 i Kushtetutës. Kjo bëhet edhe më e qartë nëse kihet parasysh dallimi që ekziston në mes të vendimeve meritore dhe atyre që nuk prekin meritat e çështjes kushtetuese. Në **Kosovë** ky dallim në aspektin formal bëhet përmes emërtimi të vendimeve: për vendimet në çështjet kushtetuese meritore përdoret termi **aktgjykim** kurse për ato vendime me të cilat një çështje kushtetuese nuk vendoset meritorisht përdoret termi **aktvendim**. Neni 116.1 i Kushtetutës i referohet dy llojeve të këtyre vendimeve, duke përjashtuar nga ky definim, në të njëjtën kohë, çdo vendim tjetër që Gjykata Kushtetuese e merr jashtë ushtrimit të juridiksionit nga neni 113 i Kushtetutës. **Kjo nënkupton se çdo organ, institucion, përfshirë gjyqësorin e rregullt, si dhe çdo individ në Kosovë janë të detyruar që të përulen me nderim ndaj vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të miratuara gjatë ushtrimit të kompetencave nga neni 113 i Kushtetutës dhe kompetencave të tjera shtesë.** Përulja me nderim nënkupton, siç e thamë më sipër, tri gjëra:

- e para, përulje me qëllim të respektimit të vendimeve juridiksionale të Gjykatës Kushtetuese;
- e dyta, përulje me qëllim të përshtatjes së sjelljeve të subjekteve të së drejtës nga neni 116.1 i Kushtetutës konform urdhrave të vendimeve juridiksionale të Gjykatës Kushtetuese; dhe, në fund,

[14] Rregulli 36 ["Kriteret e pranueshmërisë"] i RP :
"[…] (3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur: … d) Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri".

[15] European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), "The role of the constitutional court in the consolidation of the rule of law " **CDL-STD(1994)010** Or. Engl. Në *Science and technique of democracy No.10*. **Proceedings of the UniDem Seminar organised in Bucharest on 8-10 June 1994 in co-operation with the Romanian Constitutional Court with the support of the Ministry of Foreign Affairs of Romania.** Në internet: https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-STD(1994)010-e (shikuar në korrik 2018) fq. 64-99 në fq. 67.

- tre, fund, ekzekutimi i vendimeve juridiksionale nga ana e subjekteve të nenit 116.1 të Kushtetutës kur një gjë e tillë kërkohet nga ta sipas Kushtetutës, ligjeve dhe akteve të tjera juridike.

Doktrina **stare decisis**, ndërkaq, ka të bëjë me përmbajtjen dhe cilësitë konkrete të vendimit juridiksional të një gjykate kushtetuese dhe marrëdhënien e tij ndaj cilësive konkrete të çështjeve kushtetuese, pra jo ndaj cilësive të vendimeve, çështje që duhet të vendosen në të ardhmen. Kjo marrëdhënie përcaktohet me ligj apo përmes praktikës gjyqësore, asnjëherë me kushtetutë nacionale. Në të njëjtën kohë, kjo marrëdhënie i takon aspekteve jo procedurale të trajtimit të një rasti apo mosmarrëveshjeje konkrete kushtetuese. Këto aspekte jo procedurale të **stare decisis**, për dallim nga aspektet procedurale të **res judicata** të përshkruara si më sipër, që kanë të bëjnë me **efektin prekluziv** (përjashtues) të një vendimi konkret, asnjëherë nuk mund të sanksionohen me kushtetutë dhe ligje por vetëm përmes praktikës gjyqësore (jurisprudencës).

Përveç kësaj, **stare decisis** nuk njihet në të gjitha sistemet dhe kulturat juridike: vetëm kulturat specifike juridike, të njohura si sistemi i të **drejtës së përgjithshme (common law)** e njohin dhe e pranojnë doktrinën **stare decisis**. Në sistemin e tillë, një gjë e tillë është kështu si pasojë e faktit se organi më i lartë i pushtetit gjyqësor në vend, që vendos edhe lidhur me çështjet kushtetuese, **per definicionem** kryen **funksionin nomoflikatik** (unifikues) për të gjitha rastet dhe mosmarrëveshjet, përfshirë këtu edhe ato që kanë natyrë kushtetuese. Kjo nënkupton që fuqia juridike e doktrinës stare decisis buron nga fakti se **funksioni nomofilaktik** kryhet nga instanca e fundit gjyqësore në nivel nacional, vendimet e së cilës janë të detyrueshme ligjërisht për krejt instancat më të ulëta. Një gjë e tillë është imanencë e sistemeve juridike të së **drejtës së përgjithshme**, dhe asnjëherë e sistemeve juridike të së **drejtës civile (kontrinentale)**: në **sistemin civil** ku ekziston një gjyqësi e ndarë kushtetuese, e centralizuar në duart e një organi të vetëm me juridiksion të qartë për të vendosur në çështjet kushtetuese, e njohur si gjykata kushtetuese, nuk ka asnjë kuptim diskutimi i doktrinës stare decisis sepse gjykata kushtetuese në këto vende dhe në këto modele të gjyqësisë së centralizuar kushtetuese nuk ushtron **funksion nomoflikatik**. Ajo bën interpretimin përfundimtar të kushtetutës, me fuqi të përgjithshme detyruese **(erga omnes).** Kjo fuqi e përgjithëshme detyruese (erga omnes), e cila nuk i atribuohet asnjërit prej vendimeve të tjera të gjyqësorit të rregullt apo administratës shtetërore, buron nga kushtetuta nacionale, e cila i jep monopol ekskluziv gjykatës kushtetuese për interpretimin përfundimtar të kushtetues dhe kontrollin e kushtetutshmërisë së veprimeve he mosveprimeve të akterëve shtetërorë/politikë, duke përjashtuar çdo organ tjetër apo individ nga ky interpretim dhe ky kontroll i kushtetutshmërisë.[16]

Të rralla janë vendet që lejojnë goditjen e vendimeve të gjykatës kushtetuese me mjete juridike apo sfidimin e tyre pranë një organi tjetër në nivel nacional. Kosova, siç kemi parë, bën pjesë në këtë përjashtim: Kushtetuta lejon mundësin e tillë vetëm sa i përket vendimit lidhur me shkarkimin e **Presidentit të Republikës.**[17] I ngjashëm ka qenë rasti me **Rumaninë**, për çka kemi folur në seksionin 5.3

[16] Cf. për një qëndrim ndryshe te Visar Morina, "The *Legal Prospective Force of Constitutional Courts Decisions: Reflections from the Constitutional Jurisprudence of Kosovo and Beyond",* fq. 21-23, që barazon fuqinë detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nga neni 116.1 i Kushtetutës me efektet juridike të **stare decisis**: në sistemin civil fuqia detyruese e vendimeve të një gjykate kushtetuese nuk nënkupton efektin **stare decisis**, pra efektin e burimit të së drejtës, sepse nuk ka burim tjetër të së drejtës pos atyre të përcaktuar me kushtetutë nacionale (nëse kushtetuta nuk përcakton hierarkinë e burimeve, atëherë vetë ajo vjen e para, kurse ligji dhe aktet e tjera të përgjithshme e fitojnë hierarkinë bazuar në ndonjë akt tjetër juridik). Në këto burime juridike nacionale nuk hyjnë vendimet e gjykatave kushtetuese sepse, në parim, ato nuk krijojnë normë të re kushtetues por bëjnë interpretimin e tyre. Kjo nënkupton se në të ardhmen, për deri sa vendimi që interpreton një normë është në fuqi, çdo subjekt i së drejtës duhet ta kuptoj normën e tillë kushtetuese ashtu siç ka thënë **Gjykata Kushtetuese** në vendimin e saj.

[17] Neni 91 ["Shkarkimi i Presidentit"] i Kushtetutës:
"1. Presidenti i Republikës së Kosovës mund të shkarkohet nga Kuvendi nëse ai/ajo është dënuar për kryerjen e krimit të rëndë ose nëse ajo/ai nuk është i/e aftë për të ushtruar përgjegjësitë e këtij posti për shkak të sëmundjes së rëndë ose nëse Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar se ajo/ai ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës.
3. Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës është dënuar për ndonjë krim të rëndë ose kur nëse Kuvendi, në pajtim me këtë nen, konstaton që Presidenti nuk është i aftë të ushtrojë përgjegjësitë e tij/saj për shkak të sëmundjes së rëndë ose nëse Gjykata Kushtetuese konstaton se ajo/ai ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës, Kuvendi mund të shkarkojë."

të kapitullit të pestë të librit. E njëjta logjikë vlen, **mutatis mutandis**, për vendimet juridiksionale të aktgjykimeve të gjykatave kushtetuese në Itali dhe Gjermani të cilat shtyejnë anulimin e vendimit jo-kushtetues për arsye të ndryshme, të cilat i diskutojmë në seksionet në vijim. Këtu vendime që shtyjnë anulimin e ligjit apo të normës së gjetur si jo në pajtim me kushtetutën nacionale, megjithatë, kanë efekt të përgjithshme (**erga omnes**): kjo nënkupton se fuqia e detyre detyruese është e njëjtë si e vendimeve që anulojnë ligjin apo normën me efekt të menjëhershëm. Të gjithë detyrohen t'i respektojnë me përulësi ato, kurse shtyrja e efekteve të tyre nuk është asgjë tjetër pos menaxhim kohor i efekteve të vendimit, të cilat fillojnë të prodhohen në kohën dhe mënyrën e përcaktuar me vendim të gjykatës përkatëse kushtetuese.

Në këtë kontekst duhet parë formulimin e nenit 116.1 të Kushtetutës, pra, në kuptimin që çdo vendim juridiksional i marrë gjatë ushtrimit (ekzekutimit) të kompetencave nga neni 113 i Kushtetutës është i detyrueshëm për të gjithë, pa marrë parasysh a është vendim meritor apo jo, kurse efekti **stare decisis** lidhet me substancën (cilësinë) përmbajtësore të vendimit dhe marrëdhënien e tij me çështjet kushtetuese që duhet të zgjidhen në të ardhmen. Kjo marrëdhënie përcaktohet nga ligji dhe jurisprudenca nacionale, jo nga kushtetuta përkatëse. Në të shumtën e rasteve, vendimet për çështjet jomeritore në vendet ku njihet efekti **stare decisis** nuk mund të kenë një efekt të tillë, ani se janë me fuqi të përgjithshme detyruese **(erga omnes)**. Kjo vlen edhe për **Kosovën**, e cila detyrohet të vë në jetë **stare decisis** të **Gjykatës së Strasburgut** për aq sa vendimi ka të bëjë me liritë dhe të drejtat e njeriut. Kjo nënkupton se aktvendimet për papranueshmëri në rastet kur ankuesi nuk është viktimë e shkeljes kushtetuese, në parim, nuk mund të kenë efekt **stare decisis**, në ndërkohë që të njëjtat vendime kanë fuqi të përgjithshme detyruese (erga omnes) në kuptim të nenit 116.1 të Kushtetutës. Kjo nënkupton se subjektet e së drejtës në Kosovë, të përmendur në këtë nen kushtetues, detyrohen ta respektojnë një vendim të tillë jo-meritor për shkak të fuqisë së përgjithshme të detyrueshme **(erga omnes)**, në ndërkohë që ai vendim nuk ka asnjë efekt stare decisis. Ai nuk mund të ketë një efekt të tillë sepse nuk ka substancë (përmbajtje).

Vendimet jo-meritore kanë substancë vetëm për **Gjykatën Kushtetuese** për shkak se ato shërbejnë si një test për vlerësim të pranueshmërisë procedurale të kërkesës, përkatësisht për të përcaktuar nëse një palë mund të ketë legjitimitet aktiv procedural në një procedim të ardhshëm kushtetues në **Gjykatën Kushtetuese**. Ky parametër dhe ky test ka natyrë absolute sa i përket pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht përcakton legjitimitetin aktiv të një pale në procedurë, përcaktim që nuk buron, megjithatë, si pasojë e doktrinës **stare decisis** por e përcaktimit ligjor të kushteve të pranueshmërisë së një kërkese, të cilat kushte më pastaj operacionalizohen me **Ligjin nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese (Ligjin nr. 03/L-121)** dhe Rregullat e Procedurës të Gjykatës Kushtetuese (**RP**).

Kjo është një çështje krejtësisht tjetër nga **stare decisis**. Thënë me fjalë të tjera, aktiviteti i Gjykatës Kushtetuese në lëmin e vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës asnjëherë nuk paraqet interpretim të Kushtetutës dhe, për pasojë, nuk krijon e as nuk prish precedente (nuk formon **stare decisis**). Ky aktivitet, si i tillë, nuk ka asnjë relevancë për subjektet kushtetuese nga neni 116.1 të Kushtetutës sepse ka të bëjë ekskluzivisht me Gjykatën Kushtetuese dhe me përcaktimin e saj lidhur mbi pranueshmërinë e një kërkese, duke u bazuar në dispozitat e **Ligjit nr. 03/L-121** dhe **RP**. Këtu bëjnë përjashtim rastet e vlerësimit të pranueshmërisë nga neni 113.7 i Kushtetutës (shterja e mjeteve juridike) si dhe rastet e tjera të pranueshmërisë që gjenden të përcaktuara me Kushtetutë. Edhe në këto situata, megjithatë, fjala është për çështje jo-meritore të natyrës procedurale: **stare decisis** nuk ka të bëj aspak me vendimet e marra gjatë vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesave nga neni 113.7 i Kushtetutës dhe vlerësimeve të tjera pranueshmërisë së kërkesave kushtetuese, të cilat, si të tilla, kanë për parametër vlerësues dispozitat e tjera kushtetuese.

Ky shtjellim deri këtu e bën të qartë se efekti **stare decisis** në një vend si Kosova, që modelohet sipas recetës **kelseniane/evropaine** dhe që i takon sistemit të së **drejtës civile**, mund të lind vetëm

në vendimet meritore që merren sipas nenit 113.7 i Kushtetutës, lidhur nenin 53 të saj, jo edhe me vendimet tjera të marra në vijim të ushtrimit (ekzekutimit t) të juridiksionit tjetër kushtetues nga neni 113 i Kushtetutës. Kjo nuk është e njëjtë me fuqinë detyruese nga neni 116.1 i Kushtetutës, që i njeh forcën e detyrueshme të gjitha vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, pra efektin **erga omnes**, pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për vendime meritore ose jo-meritore apo vendime të nxjerra në vijim të ushtrimit të juridiksionit tjetër nga neni 113 i Kushtetutës. Në raste e efekti **stare decisis**, vendimi i mëparshëm, jo neni përkatës i kushtetutës nacionale, shërben si bazë juridike për vendimmarrje në lidhur me një tjetër të ri rast në të ardhmen.[18] Kjo nënkupton se për të shërbyer si bazë juridike për vendimmarrje, ai vendim duhet të ketë natyrë meritore. Kjo është kështu sepse vetëm vendimet meritore interpretojnë kushtetutën në vendet e sistemit evropian/kelsenian, pa marrë parasysh që në këtë sistem ato nuk shërbejnë si precedent (stare decisis), me përjashtim të Kosovës si rezultat i detyrimit kushtetues nga neni 53 i Kushtetutës (këtu hyn edhe Bosnje-Hercegovina, në të cilën ekziston një detyrim i njëjtë kushtetues kundrejt precedenteve të Strasburgut).[19] Kjo nënkupton se ky efekt stare decisis ka të bëjë vetëm me precedentet me origjinë nga **Gjykata e Strasburgut**: kërkesat kushtetuese nga neni 113.7 i Kushtetutës, që iniciohen me **ankesë kushtetuese**, duhen para nga prizma e efekteve juridike që prodhon **res judicata** dhe caqet e saj në kuptimin objektiv dhe subjektiv, jo si precedente sepse ato vendime kanë efekte **in-**

---

18 Cf. autorin Visar Morina, *"*The *Legal Prospective Force of Constitutional Courts Decisions: Reflections from the Constitutional Jurisprudence of Kosovo and Beyond",* fq. 20 (ku autori ngatërron këto dy koncepte, duke iu referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin **KO 98/11** lidhur me imunitetin e funksionarëve të lartë publik në Kosovë).

19 Autorët **Arsim Bajrami** e ***Florent Muçaj*** *mendojnë se* ***Gjykata Kushtetuese bën interpretimin e kushtetutës me aktgjykime dhe aktvendime. Në mënyrë specifike,*** duke iu referuar rastit të zgjedhjes së **Hashim Thaçit** për President të Kosovës, autorët gabimisht besojnë se aktvendimi për papranueshmëri, së bashku me arsyetimin e dhënë në këtë rast, ka ndryshuar precedentin e vendosur nga Gjykata Kushtetuese në rastin **Pacolli**. Në rastin **Pacolli** ka pasur një aktgjykim, kurse në rastin **Thaçi** ka pasur aktvendim. Ky i dyti fare nuk ka prekur meritat e rastit, si çdo aktvendim tjetër i dhënë nga **Gjykata Kushtetuese**. Autorët nuk shtjellojnë asnjë pjesë të asnjërit prej dy vendimeve të dhëna në rastet si më sipër. Një analizë e tyre, megjithatë, e bënë të qartë dhe e ven në spikamë faktin se në rastin e zgjedhjes së **Hashim Thaçit** për **President të Kosovës**, **Gjykata Kushtetuese** në një pjesë të arsyetimit të vet ka ripërsëritur pjesët e Aktgjykimit **KO 29/11** (rasti **Pacolli**), me qëllim të argumentimit të pabazueshmërisë së kërkesës në pjesën që ka pretenduar se çdoherë duhet të jenë në sallë 120 deputetët e **Kuvendit të Kosovës**. Përveç kësaj, Gjykata në Aktvendimin në rastin **KO 47/16** (rasti **Thaci**) ka sqaruar se në rastin **Pacolli** (rasti **KO 29/11**) ka pasur shkelje të procedurave sepse nuk janë mbajtur dy raundet e para fare, në ndërkohë që brenda në sallë të Kuvendit kanë qenë më pak se 2/3 (dy të tretat) e deputetëve. Kjo shumicë e kualifikuar, sipas Aktgjykimit në rastin **KO 29/11** (rasti **Pacolli**), nuk përbën kuorumin por përcaktuesin e kuorumit: çdoherë kur për një vendim kërkohet një shumicë e kualifikuar, atëherë ajo shumicë e kualifikuar përbën vetë kuorumin, pat thënë **Gjykata Kushtetuese** në Aktgjykimin në rastin **KO 29/11** (rasti **Pacolli**). Vetëm në rastin e dytë ka ndodhur raundi i dytë dhe i tretë i zgjedhjes për President dhe këtë nuk e ka vlerësuar **Gjykata Kushtetuese** me Aktvendimin në rastin **KO 47/16** sepse kërkesa e parashtruesve ka kontestuar shkeljen e procedurave për shkak se në Kuvend nuk kanë qenë 120 deputetë e Kosovës. Më këtë argument, kërkuesit qartazi e kanë interpretuar në mënyrë të gabuar dhe, për pasojë, e kanë keqkuptuar në tërësi prezencën totale të krejt deputetëve, duke e parë atë si një kusht të domosdoshëm për kushtetutshmërinë e zgjedhjes së **Presidentit të Kosovës**. Pjesa e arsyetimit të Aktvendimit në rastin **KO 47/16** (rasti **Thaçi**), e dhënë në paragrafët 68-73, paraqet një **obiter dicta** që ka të bëjë ekskluzivisht me një situatë krejtësisht hipotetike, që nuk ka ndodhur e as nuk është testuar në rastin **Pacolli**, i vendosur me Aktgjykimin **KO 29/11**. Kjo **obiter dicta** nuk ka të bëj aspak me vendosjen e një standardi të ri, nuk ka relevancë kushtetuese dhe as peshë të natyrës së një precedenti sepse nuk i referohet kërkesës së parashtruesve dhe as pjesës operative të Aktvendimit **KO 47/16**. Thëne me fjalë të tjera, standardi që ka të bëjë me cilësinë (vlerën) kushtetuese të raundeve të zgjedhjes për **President të Kosovës** nuk është testuar asnjëherë në rastin **Pacolli**, ku **Gjykata Kushtetuese** me aktgjykim ka vlerësuar në mënyrë të saktë dhe meritorisht vlerën kushtetuese e procedurave për zgjedhjen e Presidentit të Kosovës me efekt **erga omnes,** duke konstatuar se procedura është shkelur në dy raundet e para, jo në raundin e tretë, i cili fare nuk ka qenë objekt i kërkesës për kontroll kushtetues**.** Në këtë kuptim, ai standard ngelet në fuqi dhe vlen në aspektin kushtetues deri në testimin e kushtetutshmërisë së tij në një rast tjetër kur do të ketë shkelje të raundit të parë dhe të dytë të votimit për **President të Kosovës** në kuptim të nenit 86.5 ["Zgjedhja e Presidentit"] të Kushtetutës, ashtu siç është interpretuar nga **Gjykata Kushtetuese** në paragrafët 80-85 të Aktgjykimit në rastin **KO 29/11** (rasti **Pacolli**). Cf. Arsim Bajrami & Florent *Muçaj, E drejta kushtetuese* (Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina": Prishtinë, 2018) fq. 475-476; Cf. *Rasti KO 29/11.Aktgjykim. Parashtruesi: Sabri Hamiti dhe deputetë të tjerë. Vlerësimi i kushtetutshmërisë të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, i datës 22 shkurt 2011.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Nr. ref.: AGJ 107/11. Prishtinë, më 30 mars 2011. Paragrafët 5, 15-22, 78-87; *Rasti K0 47/16. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Aida Derguti, Bali Muharremaj, Enver Hoti dhe 25 deputetë te tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr, 05-V-233, të 26 shkurtit 2016, për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.: RK 911/ 16. Prishtinë, më **4 prill** 2016. Paragrafët 25-29 & 68-73.

ter partes. Roli dhe rëndësia e precedentit këtu ka për pikë referimi jurisprudencën e **Gjykatës së Strasburgut**, jo Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës: vendimet e Gjykatës nga neni 113.7 i Kushtetutës përbëjnë **res judicata** me efekt **inter partes** dhe nuk shërbejnë si një bazë e re juridiko-kushtetuese për vendosjen e rasteve pranë gjyqësorit të rregullt, i cili ka detyrim të njëjtë, sipas nenit 53 të Kushtetutës, siç e ka vetë Gjykata Kushtetuese.[20] Kjo nënkupton që nuk përjashtohet mundësia që vendimmarrja në gjyqësorin e rregullt të bazohet në vendimet meritore të Gjykatës së Strasburgut, pa përmendur këtu vendimet e Gjykatës Kushtetuese mbi të njëjtën liri apo të drejtë kushtetuese. Në aspektin vertikal, thënë ndryshe, **Gjykata Kushtetuese** rri në raport të njëjtë me **Gjykatën e Strasburgut**, siç rrinë gjyqësori i rregullt dhe krejt autoritetet e tjera publike, konform detyrimit kushtetues nga nenit 53 i Kushtetutës. Jo vetëm kaq! Në vet origjinën teorike të rëndësisë dhe rolit të së drejtës në përgjithësi, që personifikohet me juristin e filozofin e së drejtës Fredrik Karl fon Savinji (**Friedrich Carl von Savigny:** 1779 – 1861), qëndron ideja mbi të drejtën si një proces induksioni me rrënjë të thella në shoqëri, si dhe ideja mbi ekzistimin e ndarjes së rreptë të punëve në mes të juridiksionit legjislativ dhe konkretizimit të akteve legjislative nga ana e gjyqësorit.[21] Këtu nuk mund të përjashtohet as gjyqësia kushtetuese ani se ka pasur raste kur autorët kanë theksuar se vendimet e gjykata kushtetuese, jo vetëm që kanë fuqi të përgjithshme detyruese (**erga omnes**), por edhe shërbejnë si burim i së drejtës. Kjo, u muar vesh, nuk mund të jetë rasti dhe këtë e sqaruam më herët: gjyqësia kushtetuese ka detyrim primar interpretimin e kushtetutës dhe ushtrimin e kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë, që së bashkë çojnë në një drejtim dhe qëllim: sqarimi dhe saktësimi i dispozitave ekzekutuese ekzistuese. **Kjo vlen edhe për rastet e gjykatave kushtetuese super-aktiviste: në momentin e ndryshimit në personel apo në ambientin e jashtëm, të njëjtat gjykata super-aktiviste detyrohen të rikthehen në binarët e fjalive që shprehim parime, vlera dhe norma kushtetuese të kushtetutave nacionale, përmbajtja e të cilave zbulohet përmes vendimeve të gjykatave kushtetuese.**

Në mbyllje të këtij seksioni ia vlen të thuhen disa fjalë për konceptet e lidhura me këtë që u diskutua më sipër. E kemi fjalën për konceptet si vijon:

- **obiter dicta**;
- **mendimi mospajtues**; dhe, në fund,
- **masa e përkohshme** dhe natyra e saj si vendim kushtetues.

Në rastet e kontrollit abstrakt të normës, si dhe në rastet e ushtrimit të kompetencave të tjera nga neni 113 të Kushtetutës, përveç atyre që kanë të bëjnë me ankesën kushtetuese, gjyqësori i rregullt dhe të gjitha autoritetet e tjera publike e private, përfshirë individët, detyrohen që, sipas fuqisë së nenit 116.1 të

---

[20] Asnjëherë vendimet e **Gjykatës Kushtetuese** nuk mund të kenë efektin e krijimit të bazës ligjore për vendimmarrje të gjyqësorit të rregullt: vendimet e saj shërbejnë vetëm për sqarimin dhe konsolidimin e bazës ekzistuese juridiko-kushtetuese. Kjo është kështu nisur nga fakti se vendimi meritor i **Gjykatës Kushtetuese** bëhet pjesë e normës kushtetuese, të cilën e interpreton, ashtu që norma së cilës i referohet vendimi meritor nuk mund të interpretohet ndryshe pos ashtu siç ka thënë **Gjykata Kushtetuese**. Këtu e kemi fjalën për kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë dhe për të gjitha kompetencat juridiksionale të **Gjykatës Kushtetuese** nga neni 113 i Kushtetutës, me përjashtim të vendimmarrjeve në rastet nga neni 113.7, që kanë për objekt kontrolli kushtetues veprimet apo aktet e një autoriteti publik (nganjëherë edhe një mosveprim apo akt tjetër që nuk ka natyrë individuale, siç ka qenë rasti me **Memorandumin e Mirëkuptimit** në çështjen e njohur si rasti **Pasaportave**, ku u konstatua cenimi i lirisë së lëvizjes). Për një mendim të ndryshëm, përkatësisht për mendimin që thotë se vendimet e **Gjykatës Kushtetuese** mund të kenë fuqinë e barabartë me ligjin, cf. Visar Morina, "The *Legal Prospective Force of Constitutional Courts Decisions: Reflections from the Constitutional Jurisprudence of Kosovo and Beyond",* fq. 19 & 21.

[21] Idetë e këtij autori mbi lidhmërinë e ngushtë në mes të së drejtës dhe shpirtit nacional të një populli e ka provuar përvoja historike e popujve të ndryshëm, që sot i takojnë demokracive liberale perëndimore. Nuk mund të ketë barazim, apo zgjerim të shtrirjes, së koncepteve, siç është koncepti i fuqisë së përgjithshme detyruese (**erga omnes**), në sferat tjera juridiksionale që prishin parimin e ndarjes së punëve në mes të degëve të ndryshme të pushtetit. Tek e fundit, po të ishin vendimet e gjykatave kushtetuese burim i së drejtës, si pasojë e fuqisë së përgjithshme të tyre detyruese (**erga omnes**), atëherë do të bëhej fjalë për delegim të pushtetit kushtetutëbërës dhe ligjvënës në gjykatat kushtetuese, gjë që përbën një absurd në vete. Cf. më shumë për këtë në një shkrim të shkëlqyer të Boštjan M. Zupančič, "Constitutional Law and the Jurisprudence of the European Court of Human Rights: An Attempt at a Synthesis*". Revus. Journal for Constitutional Theory and Philosophy of Law / Revija za ustavno teorijo in filozofijo prava*. 1 (2003) fq. 57-61 (shiko në veçanti fusnotën nr. 8 dhe tekstin që e shoqëron, ku autori e fajëson profesorin gjerman **Helmut Steinberger** që tha se vendimet e **Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë** (**GJKGje**) janë burim autentik i së drejtës).

Kushtetutës, të përulen ndaj interpretimit që Gjykata Kushtetuese ia ka bërë normës juridike me vendimin e saj. Në rastin e rasteve të vëna në lëvizje sipas ankesës kushtetuese nga neni 113.7 i Kushtetutës, gjithnjë nëse kemi të bëjmë me vendime meritore lidhur me ankesën kushtetuese, gjyqësori i rregullt dhe të gjitha autoritetet e tjera publike e private, përfshirë individët, detyrohen që në tërësi të interpretojnë liritë dhe të drejtat njerëzore sipas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, pjesës së tij arsyetuese (argumentuese), **ratio decidendi**, si dhe pjesës së tij operative. Kjo është kështu gjithnjë me supozim se gjyqësori i rregullt dhe subjektet e tjera të së drejtës si më sipër janë para situatës kur duhet të zbatojnë normën kushtetuese të interpretuar nga Gjykata, si dhe me supozimin që ai interpretim i Gjykatës nuk bie ndesh me detyrimin e saj kushtetues nga neni 53 të Kushtetutës. Kjo gjendje është pasojë e nenit 116.1 të Kushtetutës, jo e zbatimit të doktrinës **stare decisis**: ndryshe nuk ka asnjë kuptim parimi themelor i konstitucionalizmit modern, që në rastin e Kosovës mishërohet në urdhrin nga neni 116.1 i Kushtetutës, që ka të bëjë me sigurimin e supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës, të cilin supremaci (epërsi) e siguron Gjykata Kushtetuese, ani se për këtë duhet të kujdesen edhe organet e tjera kushtetuese.

Ajo pjesë e vendimit meritor që nuk përfshihet dhe nuk mund të shërbej si bazë juridiko-kushtetuese për vendimmarrjen në gjyqësorin e rregullt ka të bëj me prononcimet e Gjykatës Kushtetuese obiter dicta. Të tilla janë prononcimet që Gjykata i bën në formë të hipotezave duke imagjinuar një rast hipotetikisht të pranueshëm dhe verdiktin hipotetik që do ta kishte marrë në një rast të tillë hipotetik. Kjo mund t'i referohet si rasteve të vëna në lëvizje sipas ankesës kushtetuese ashtu edhe rasteve të tjera të ushtrimit të juridiksionit nga neni 113 i Kushtetutës. Ajo që karakterizon një **obiter dicta**, zakonisht ka të bëjë me natyrën e saj edukative: duke u futur në argumentime për të cilat nuk është pyetur, gjithnjë me qëllim të arsyetimit të verdiktit përfundimtar, Gjykata Kushtetuese targeton akterët që kanë nisur procedurën kushtetuese pranë saj, segmente të caktuara të shoqërisë që afektohen më drejtpërdrejt me vendim, si dhe publikun e gjerë me qëllim të iluminimit të tyre rreth çështjeve të komplikuara kushtetuese. Kështu është edhe në praktikën e gjyqësisë kushtetuese gjetiu në **Evropë**, së cilës i takon Kosova. Kjo është arsyeja që ka raste kur **obiter dicta** përdoret edhe në vendimet jo meritore, duke ndërtuar një rast hipotetik si të lejueshëm dhe një verdikt po ashtu hipotetik, gjithnjë me qëllim të luajtjes së rolit të saj edukativ dhe didaktik për akterët dhe subjektet e caktuara, përfshirë këtu publikun e gjerë. Thënë me fjalë të tjera, Gjykata Kushtetuese i cilëson situatat e caktuara si të panjohura për te, mirëpo dëshiron të jep mendimin e saj në **obiter dicta** me qëllim të iluminimit të subjekteve të së drejtës dhe publikut të gjerë lidhur me rëndësinë juridiko-kushtetuese të situatave periferike. I kësaj natyre është, ta zëmë, rasti i **Arijeta Halimit.**[22]

Ndryshe, në të shumtën e rasteve, **obiter dicta** përdoret në vendimet meritore, që në Kosovë kanë formën e aktgjykimit: ajo që dallon këto aktgjykime nga të tjerat që nuk përdorin **obiter dicta** është forma e argumentimit. Në rastet kur përdoren **obiter dicta**, forma e argumentimit të Gjykatës Kushtetuese zakonisht është e njohur si **këmbët e karriges**.[23] Kjo është kështu edhe jashtë Kosovës, pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për vendet që modelohen sipas sistemit **evropian/kelsenian** të gjyqësisë kushtetuese, për

---

[22] *Rasti KI 36/11. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Arjeta Halimi. Vlerësimi i kushtetutshmërisë të mos-përmbarimit të pretenduar të Aktgjykimit CN nr. 24/09, të 17 nëntorit 2009, të Gjykatës së Qarkut në Gjilan dhe shkeljes së pretenduar të të drejtave të njeriut të parashtruesit të kërkesës*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtine, më 30 shtator 2011. Nr. ref.: RK 137/11.

[23] Të tilla janë, ta zëmë, sa për ilustrim, vendimet në rastin e kontrollit kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare, si vijon: *Rasti KO 95/13. Aktgjykim. Parashtrues: Visar Ymeri dhe 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit, Nr. 04/L-199, për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të Planit të zbatimit për këtë marrëveshje*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 9 shtator 2013. Nr. ref.: AGJ 469/13.); pastaj, rastet **VLAN I** (Cf. *Rasti K0 103/14. Aktgjykim. Parashtrues: Presidentja e Republikës së Kosovës Përkitazi me vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 84 (14) [Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 1 korrik 2014. Nr. ref.: AGJ 671/14.) dhe **VLAN II** (Cf. *Rasti KO 119/14. Aktgjykim. Parashtrues: Xhavit Haliti dhe 29 deputete të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit Nr. 05-V-001, të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit te Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 17 korrikut 2014*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtinë, më 26 gusht 2014. Nr. rcf. : AGJ 700/14) etj. etj.

vendet e tjera të **modelit amerikan**, dhe, së fundi, për ato të modelit **hibrid** (të përzier). Kjo është kështu sepse strukturat tjera të argumentimit, si struktura zinxhirore dhe struktura e argumenteve reciprokisht përjashtuese por kumulativisht kuptimplote, të cilat i diskutojmë në vijim, nuk mund të durojnë konstruktin obiter dicta.[24] Ky koncept përdoret vetëm atëherë kur ka konsistencë dhe argumente autonome, më shumë së një së paku, të cilat çojnë në të njëjtin drejtim, ashtu që argumentet obiter dicta, ani se dalin nga vija kryesore e arsyetimit, sërish janë konsistente në tezën apo prezumimin fillestar të parashtruar nga Gjykata Kushtetuese që vendos lidhur me çështjen kryesore.

Çështja e **mendimeve mospajtuese** ka qenë një çështje mjaftë e diskutueshme gjatë draftimit të **Ligjit Nr. 03/L-121**. Autoritet ndërkombëtare të kohës fuqishëm kanë argumentuar se nuk duhet lejuar mendimet mospajtuese për shkak se një zgjidhje e tillë do të shkaktonte më tutje fragmentimin e Kushtetutës së vitit 2008 përgjatë linjave etnike, fetare dhe dallimeve të tjera. Si për çudi, kanë qenë pikërisht gjyqtarët ndërkombëtarë ata që kanë insistuar në futjen e mendimeve mospajtuese në praktikën e **Gjykatës Kushtetuese:** ditën e dhënies së betimit më datën 26 qershor 2009 është mbajtur mbledhja e parë e Gjykatës ku është miratuar **Rregullorja e Punës** (**RP)**. Menjëherë pas kësaj mbledhje, siç e kujton autori i parë i këtij libri, njëri nga tre gjyqtarët ndërkombëtar ka filluar të shpreh mosbesim ndaj shumicës së gjyqtarëve vendor, pa dallim etnie: nga frika se mos po vinte deri te mbivotimi i gjyqtarëve ndërkombëtarë, ky gjyqtar ndërkombëtar fuqishëm ka insistuar në futjen e mendimit mospajtues në **RP**. Kjo ka ndodhur më 23 nëntor 2010 kur është bërë amendamentimi i parë i **RP**.[25]

Vendimi për **masat e përkohshme** përbën një vendim të natyrës së përkohshme dhe urgjente me të cilin nuk zgjidhet çështja meritore, mirëpo as nuk prejudikohet zgjidhja e saj.[26] Kështu është në jurisprudencën ndërkombëtare që njeh dhe praktikon masat e përkohshme. Kështu edhe është në Kosovë me ligjet tjera procedurale, të cilat, në bazë të nenit 16 të **Ligjit Nr. 03/L-121**, zbatohen, **mutatis mutandis**, në proce-

---

24 Cf. seksioni 15.3, **infra**, dhe komentet tona aty që diskutojnë të gjitha llojet e argumentit kushtetues dhe formën e tyre të manifestimit.

25 Cf. më shumë për këtë në artikullin elokuent të autorit Visar Morina, "The Newly Established Constitutional Court in Post-Status Kosovo: Selected Institutional and Procedural Concerns". *Review of Central and East European Law Vol.* 35 Issue 2 (2010) fq. 129-158 në fq. 152-155 (ku autori flet për historinë kosovare me mendimet mospajtuese).

26 Instrumenti procedural i **masave të përkohshme** ekziston në të gjitha vendet e botës dhe në të gjitha mekanizmat gjyqësor dhe arbitral ndërkombëtar; thënë me fjalë të tjera, instrumenti i masave të përkohshme përbën një kategorie që haset në të gjitha procedurat, cilado qofshin ato (administrative, penale, civile/tregtare dhe kushtetuese), vendore dhe ndërkombëtare; vënia e tyre nga autoriteti kompetent, vendor dhe ndërkombëtar, ka për qëllim pengimin e cenimit të integritetit të çështjes kryesore që duhet të shqyrtohet dhe vendoset nga dëmtimet e pariparueshme që mund t'i shkaktohen asaj me veprimet e palëve në procedurë, palëve të treta ose nga vetë rrethanat e rastit; evitimi i dëmit të pariparueshëm që mund t'i shkaktohet integritetit të çështjes e bën definimin e masave të përkohshme si instrumente mbrojtëse më të cilat arrihet ruajtja e **status quo**-s së esencës së meritave të rastit. Cf. më shumë për instrumentin e **masave të përkohshme**, në nivel vendor, regjional dhe ndërkombëtar, në të gjitha procedurat gjyqësore dhe abritrale, historinë e lindjes së tyre dhe kuptimin aktual që ato kanë, në punimet si vijon: Benjamin Kaplan, Arthur T. von Mehren and Rudolf Schaefer, "Phases of German Civil Procedure I" *Harvard Law Review* Vol. 71 No. 7 (May, 1958), pp. 1193-1268, në fq. 1258-1261; Patricia A. Essoff, "Finland v. Denmark: A Call to Clarify the International Court of Justice's Standards for Provisional Measures" *Fordham International Law Journal* Vol. 15 Issue 3 (1991) fq. 838-878 në fq. 841, 843-844, 848-849; R. St. J. Macdonald, "Interim Measures in International Law, with Special Reference to the European System for the Protection of Human Rights" *Max-Planck-Institut für ausländisches öffentliches Recht und Völkerrech* (1992) fq. 703-740 në fq. 704, 708-709, 717-720, 731-733; 739-740; Collins Lawrence, "Provisional and protective measures in international litigation" *Collected Courses of the Hague Academy of International Law* Vol. 234 No. 3 (1992) fq. 9-238 në fq. 23; A. A. S. Zuckerman, "Quality and Economy in Civil Procedure: The Case for Commuting Correct Judgments for Timely Judgments *Oxford Journal of Legal Studies* Volume 14 Issue 3 (Autumn 1994), fq. 353–387 në fq. 368; Christian J. Tams, "Interim Orders by the European Court of Human Rights – Comments on Mamatkulov and Abdurasulovic v. Turkey" *Zeitschrift für ausländisches öffentliches Recht und Völkerrecht* 63 (2003), fq. 681-692; Susana de la Sierra, "Provisional Court Protection in Administrative Disputes in Europe: The Constitutional Status of Interim Measures Deriving from the Right to Effective Court Protection. A Comparative Approach" *European Law Journal* Vol. 10 No. 1 (January 2004) fq. 42-60 në fq. 48; Alastair Mowbray, "A New Strasbourg Approach to the Legal Consequences of Interim Measures *Human Rights Law Review* Volume 5 Issue 2 (2005) fq. 377–386 në fq. 380, 382; Petersmann, Ernst-Ulrich, "Human Rights, International Economic Law and 'Constitutional Justice' ". *European Journal of International Law* Vol. 19 No. 4 (2008) fq. 769-798 në fq. 788-792; Yves Haeck**,** Clara Burbano Herrera and Leo Zwaak, Strasbourg's Interim Measures Under Fire: Does the Rising Number of State Incompliances with Interim Measures Pose a Threat to the European Court of Human Rights? *European Yearbook on Human Rights* Vol. 11 (March 1, 2011) fq. 375-403.

durat para Gjykatës Kushtetuese në rastet ku hasen zbrazëti juridike.[27] Kjo nënkupton se në vendimin për masat e përkohshme nuk guxon dhe nuk mund të ketë mendim mospajtues. Kjo, për fakt të keq, nuk është respektuar në jurisprudencën e hershme të Gjykatës Kushtetuese: në rastin **Tomë Krasniqi vs. RTK dhe KEK** (2009),[28] dy gjyqtarë kanë bërë mendim mospajtues në të cilin kanë kontestuar anën procedurale dhe materiale të kërkesës dhe vendimit lidhur me kërkesën.[29] Njëri ndër këta gjyqtarë ka pasur konflikt të hapur të interesit, të cilin e ka heshtur dhe më vonë është kuptuar: bashkëshorti i saj ka shërbyer si avokat i **RTK**-së.[30]

Në literaturë gabimisht është menduar se mendimet mospajtuese në rastin e masave të përkohshme do të ndihmojnë në zhvillimin e Gjykatës Kushtetuese.[31] Kjo, në fakt, nuk ka dalë të jetë kështu sepse mendimi mospajtues i dhënë me shkrim në rastin e masës së përkohshme si më sipër vetëm sa ka dërguar sinjale te akterët relevant të skenës politike, si dhe te qytetari i zakonshëm për politikat populliste të **Gjykatës Kushtetuese**, jo për profesionalizmin e saj.[32] Me futjen e mendimit mospajtues, megjithatë, në **RP** u futë edhe dispozita shprehimore me të cilën ndalohej dhënia e mendimit mospajtues në rastet e kërkesave të papranueshme.[33] Kjo dispozitë pak a shumë ka amortizuar efektet negative që kanë mendimet mospajtuese në një vend me demokraci të brishtë siç është Kosova. Si e tillë është futur me insistimin e autorit të parë të këtij libri.

Nëse shikohet standardi i vendeve më me traditë se vendi ynë, apo me traditë të madhe në gjyqësinë kushtetuese, siç është rasti me **Italinë**, atëherë vërehet se pikërisht mënjanimi i populizmit dhe forcimi i profesionalizmit kanë qenë dy arsyet kryesore për ndalimin e mendimeve mospajtuese në përgjithësi: kolegjialiteti dhe vendimmarrja kolektive, pa të drejtën e mendimit mospajtues dhe konkurrues, e mbron gjyqtarin kushtetues nga politika dhe presionet e saj sepse i jep mundësinë që të shprehet lirshëm në mesin e kolegëve dhe të vendos sipas rregullave të profesionit

---

27 Neni 16 [“Rregulli i përgjithshëm”] **Ligjit Nr. 03/L-121**:
“1. Dispozitat e kësaj pjese zbatohen ndaj të gjitha procedurave gjyqësore para Gjykatës Kushtetuese, përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë ligj.
2. Në rast të mungesës së dispozitave procedurale, Gjykata zbaton në mënyrë të arsyeshme dhe analoge dispozitat përkatëse të ligjeve tjera procedurale duke marrë parasysh natyrën e çështjes, si dhe veçoritë e procedurës para Gjykatës Kushtetuese.”

28 *Rasti KI 11/09. Vendim. Masë e Përkohshme/MP/. Tomë Krasniqi vs. RTK (“Radio Televizioni Kosovës”) dhe KEK (“Korporata Energjetike e Kosovës”)*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtinë, më 16 tetor 2009. Akti. Nr. MP : 01/09.

29 Cf. Mendim Mospajtues. **Almiro Rodrigues**. Rasti KI 11/09. Tomë Krasniqi vs. RTK (“Radio Televizioni Kosovës”) dhe KEK (“Korporata Energjetike e Kosovës”). **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. Protok. 116/09. Prishtinë, më 20 tetor 2009; Mendim Mospajtues. **Gjyljeta Mushkolaj**. Rasti KI 11/09. Tomë Krasniqi vs. RTK (“Radio Televizioni Kosovës”) dhe KEK (“Korporata Energjetike e Kosovës”). **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. Protok. 141/09. Prishtinë, më 23 tetor 2009. Ky, për fat të mirë, ka qenë rasti i vetëm dhe më nuk ka pasur mendime mospajtuese në vendimet e Gjykatës Kushtetuese për masë të përkohshme.

30 Cf. Vendim i Bordit për Ankesa Ref. 1503/213/BA/dk i datës 3 mars 2015. **Republika e Kosovës**. Komisioni i Pavarur i Mediave. Në këtë rast, si përfaqësues i palës ankuese, RTK, ka qenë **Naser Gjinovci**, avokat nga Prishtina, kurse vetë rasti është animuar në vitin 2010, pikërisht në kohën kur është trajtuar rasti i RTK në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe është vënë mendimi mospajtues nga bashkëshortja e avokatit **Naser Gjinovci**, gjyqtarja **Gjyljeta Mushkolaj**. Në internet: http://www.kpm-ks.org/materiale/ dokument/ 1426689009.8373.pdf (shikuar në korrik 2019).

31 Visar Morina, “The Newly Established Constitutional Court in Post-Status Kosovo: Selected Institutional and Procedural Concerns” fq. 154-155 (edhe pse autori pajtohet që në Kosovë, në fillimet e para të punës së Gjykatës Kushtetuese, **mendimet mospajtuese** nuk kanë mund të jenë të dobishme dhe mund ta kenë dëmtuar imazhin dhe punën e saj).

32 Në vendet ish-komuniste ku është kultivuar **mendimi mospajtues** që nga fillimi i themelimit të gjyqësisë kushtetuese është vërejtur se ka pasur rritje në dhënien e mendimeve të tilla si rezultat i lidhjeve politike të gjyqtarëve dhe i dëshirës së tyre për të përçuar mesazhe politike të politikanët. Cf., ta zëmë, rastin e **Gjykatës Kushtetuese të Republikës Ceke** në Zdeněk Kühn, “The Constitutional Court of the Czech Republic”. Në Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* (Cambridge, fq. 199-236 në fq. 230-231.

33 Rregulli 61 [“Mendimet mospajtuese”] i RP:
“(1) Gjyqtari i Gjykatës ka të drejtë të përgatisë një mendim mospajtues me shkrim ndaj një Aktgjykimi të Gjykatës. Gjyqtarët e tjerë mund t’i bashkëngjiten mendimit mospajtues, i cili duhet të japë arsyet konkrete përse gjyqtari nuk pajtohet me mendimin e shumicës së Gjykatës. (2) Gjyqtari i Gjykatës nuk ka të drejtë të përgatisë një mendim mospajtues ndaj një aktvendimi për papranueshmëri ose një vendimi të Gjykatës. Çdo gjyqtar ka të drejtë të tregojë në një aktvendim të tillë për papranueshmëri ose në një Vendim që gjyqtari nuk është pajtuar me shumicën.”

dhe bindjes së lirë.[34] Kjo nuk do të thotë se mendimet mospajtuese janë të ndaluara në shumicën e vendeve të demokracive kushtetuese. Krejt e kundërta: historikisht shikuar, ekziston një trend në rritje i lejimit të mendimeve mospajtuese. Në vendet e **sistemit të së drejtës së përgjithshme**, mendimet mospajtuese kanë një traditë të gjatë dhe kanë qenë si rregull përgjatë zhvillimit të gjyqësisë në këto vende, në ndërkohë që ky nuk ka qenë rasti me vendet e **sistemit kontinental**. Në këto vende, vetëm kohëve të fundit, viteve të fundit, ka depërtuar ideja e mendimeve mospajtuese dhe kjo është bërë si pasojë e ndikimit të **sistemit të së drejtës së përgjithshme**.[35] Si arsyetim për këtë merret rritja e transparencës në vendimmarrje si dhe kontrolli publik i administrimit të drejtësisë në përgjithësi.[36] **Kjo, megjithatë, çdoherë ka të bëjë me vendimet meritore dhe asnjëherë me vendimet që kanë natyrë procedurale dhe jo-meritore, siç ka ndodhur rasti me Kosovën kur u paraqit mendimi i sipërcekur mospajtues në rastin e RTK-së.**[37]

15.2. Llojet e vendimeve për nga natyra juridike dhe efektet që prodhojnë

Për nga natyra e tyre juridike, përkatësisht për nga sasia dhe cilësia e të drejtave dhe detyrimeve që përcaktojnë për palët dhe ambientin e përgjithshëm përreth, vendimet e gjykatave kushtetuese ndahen në **vendime që nuk gjejnë shkelje kushtetuese** dhe në **vendime që gjejnë shkelje kushtetuese**. Këtu bëhet fjalë, në rend të parë, për vendimet e dhëna në **procedurat e kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë** (të normave kushtetuese dhe normave ligjore, si dhe të çdo norme tjetër me karakter të përgjithshëm), ani se e njëjta vlen, **mutatis mutandis**, edhe për llojet tjera të vendimeve.

Ka shumë rëndësi që në fillim të sqarohen llojet e vendimeve për nga natyra e tyre juridike në kontekstin e procedurave standarde të kontrollit abstrakt të normës, të cilat procedura paraqesin shenjën dalluese të jetës dhe punës së gjykatave kushtetuese, që nga lindja e gjyqësisë **evropiane/kelseniane** e deri më sot. Përjashtimet nga kjo rregull, përkatësisht nga rregulli i shtjellimit kryesisht vetëm të vendimeve lidhur

---

34 Tania Groppi and Irene Spingo, "The Constitutional Court of Italy". Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 516- 559 në fq. 525 & 552.
Në fillim, kur është bërë themelimi i **GJKGje,** nuk ka ekzistuar mendimi mospajtues dhe, për arsye të njëjta si në Itali, ka qenë refuzuar futja e tij në mënyrën e vendimmarrjes kushtetuese gjermane. Kjo ka qenë rezultat i traditës së gjatë kundër mendimit mospajtues në gjyqësorin e rregullt gjerman. Cf. për trajtim të detajuar të arsyeve dhe të gjendjes rreth mendimit mospajtues në shoqërinë gjermane, përfshirë gjyqësinë kushtetuese, në Kurt H. Nadelmann, "The Judicial Dissent: Publication v. Secrecy" *The American Journal of Comparative Law* Vol. 8 No. 4 (Autumn, 1959), fq. 415-432 në fq. 427-429. Në Gjermani, aktualisht, lejohet dhe kultivohet mendimi mospajtues. Në fakt, mendimet mospajtues në Gjykatën Kushtetuese të Gjermanisë janë mjaft të gjata dhe elaborative të parimeve dhe normave kushtetuese, që larg tejkalojnë mendimin e shumicës. Kjo kthesë në gjyqësinë kushtetuese gjermane rezulton të jetë pasojë e pjekurisë së demokracisë kushtetuese gjermane dhe ndryshimit të kulturës kushtetuese gjermane Cf. më shumë në Michaela Hailbronner and Stefan Martini, "German Constitutional Court". Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 356-393.

35 Në fakt, në literaturë është vërejtur se sistemi i hershëm it ë drejtës romake (kontinentale/civile) ka njohur mendimet mospajtuese dhe publikimin e këshillimit dhe votimit. Kjo ka ndryshuar më vonë, nën ndikimin e **Kishës Katolike** dhe është ruajtur deri vonë. Kjo nuk ka qenë kështu me sistemin anglo-sakson të së drejtës së përgjithshme, të cilat që nga fillimi në të shumtën e kohës kanë kultivuar mendimin mospajtues dhe transparencën e votës, këshillimit dhe mendimit të gjyqtarëve. Në kuadër të sistemit civil të së drejtës, **Franca** dhe vendet që janë modeluar sipas sistemit gjyqësor francez kanë pasur një sistem më sekret të këshillimit dhe votimit, si dhe mungesë të tërësishme të mendimeve mospajtuese. E njëjta vlen edhe për **Spanjën** dhe **Portugalinë**, ani se ndikimi i tyre në ish-kolonitë e veta ka qenë i vogël sepse shumica e vendeve të **Amerikën Latine** ka aplikuar sistemin anglo-sakson të gjyqësisë, në kuadër të së cilës e kanë future gjyqësinë kushtetuese. Cf. më shumë për këtë në Kurt H. Nadelmann, "The Judicial Dissent: Publication v. Secrecy", fq. 422-425 (për **Francën**) dhe fq. 420-421 (për **Spanjën** dhe **Portugalinë**).

36 Kurt H. Nadelmann, "The Judicial Dissent: Publication v. Secrecy", fq. 429-432. Për analizën komparative të arsyeve për dhe kundër futjes së mendimeve mospajtuese në gjyqësinë kushtetuese, Cf. më shumë në European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Report on Separate Opinions of Constitutional Courts.* Adopted by the Venice Commission at its 117th Plenary Session (Venice, 14-15 December 2018). Strasbourg, 17 December 2018. **Opinion No. 932/2018**. CDL – AD (2018) 030. Orig.: English. Paragrafët: 15-32. Në internet: https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2018)030-e.

37 Aktualisht në gjyqësinë kushtetuese evropiane vendet që nuk lejojnë mendime mospajtuese janë në pakicë. Sot janë si vijon: **Austria**, **Belgjika**, **Franca**, **Italia**, **Irlanda, Luksemburgu** dhe **Malta**. Vendet tjera lejojnë mendimet në fjalë. Në **Gjykatën e Strasburgut** po ashtu lejohet mendimi mospajtues në çështjet meritore, kurse në **Gjykatën e Drejtësisë të Unionit Evropian** një gjë e tillë nuk lejohet. Cf. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Report on Separate Opinions of Constitutional Courts.* Paragrafët: 7-9.

me kontrollin abstrakt të normave jepen në mënyrë të veçantë përgjatë diskutimit tonë, për aq sa një gjë e tillë ka relevancë për integritetin e këtij kapitulli marrë si tërësi.

Sikundër u tha në seksionin paraprak, dhe siç do të shihet në vijim, praktika e gjykatave kushtetuese është pasuruar dukshëm përtej botëkuptimit klasik kelsenian të gjykatave kushtetuese si ligjvënësit negativ, që shprehet përmes verdiktit **shkelje** vs. **jo-shkelje (kushtetuese)**, përkatësisht përmes praktikës sipas së cilës **vendimi shpall se një normë/ligj është kushtetues** vs. **vendimi shpall se norma/ligji është jo-kushtetues.** Kjo ndryshe shprehet në dikotominë e njohur: vendim që konstaton se norma/ligji i kontestuar nuk është në pajtim me kushtetutën dhe vendim që konstaton se norma/ligji i kontestuar është në pajtim me kushtetutën. Në këto raste, vendimi i gjykatës kushtetuese zakonisht, në të njëjtën kohë, ngërthen një dikotomi tjetër që shprehet përmes verdiktit **anulim** vs **konfirmim** i normës/ligjit të kontestuar. Kjo dikotomi standarde e vendimeve që gjejnë shkelje kushtetuese dhe atyre që nuk gjejnë shkelje kushtetuese dominon në të shumtën e rasteve të vendimmarrjes nëpër gjykata kushtetuese. Motivi kryesor i kësaj tipologjie bazohet në ruajtjen e legjitimitetit të ligjvënësit dhe, për pasojë, në ruajtjen e legjitimitetit të vetë gjykatave kushtetuese, të cilat jo rrallë akuzohen për uzurpime të funksionit ligjvënës dhe për ndërhyrje në punën e organeve të tjera kushtetuese.

Tipologjia si më sipër e vendimeve, e pasuruar në ndërkohe nga praktika e gjyqësisë kushtetuese evropiane, ka rëndësi vetëm sa i përket dallimit të efekteve juridike të vendimeve të gjykatave kushtetuese në sferën e kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë. Për modalitetet e këtij pasurimi të dikotomisë klasike **shkelje kushtetuese** vs **joshkelje kushtetuese** flasim poashtu në vijim, brenda secilit seksion dhe nënseksion që ka të bëjë me këto dy tipologji kryesore. Në tenorët/verdiktet (pjesët operative) e vendimeve meritore që japin përgjigje negative lidhur me kushtetutshmërinë e normës/ligjit, përkatësisht në tenorët/verdiktet (pjesët operative) që shpallin (deklarojnë/gjejnë) se norma/ligji është jokushtetues gjenden formulime dhe shprehje të ndryshme për të përshkruar pasojat imediate që godasin objektin e tillë që ka qenë **thema decidendum**. Ato shprehje e formulime zakonisht janë si vijon: **"norma/ligj është pa asnjë fuqi", "norma/ligji është i pavlefshëm", "norma/ligji është i pa aplikueshëm", "shfuqizohet norma/ligji",** apo **"norma/ligji më nuk ka forcë".**

Këto formulime dhe shprehje që zakonisht i gjejnë në pjesën operative (tenori/verdikti), në të shumtën e rasteve përcaktohen nga ligji institucional apo organik që rregullon funksionimin dhe organizimin e gjykatës përkatëse kushtetuese. Këto ligje në mënyrë mjaft të detajuar përcaktojnë se cilat pasoja juridike, si dhe koha e caqet tyre rrjedhin si rezultat i deklarimit jo kushtetues të një normë apo ligji. Nëse këto pasoja juridike do të kenë efekte **ex nunc** apo **ex tunc**, sipas përcaktimit ligjor në bazë të vendimit të gjykatës, po ashtu përcaktohet me ligjet në fjalë. Kështu është rasti edhe me Kosovën: **Ligji Nr. 03/L-121** në mënyrë specifike përcakton efektet juridike që prodhon secili vendim konkret i dhënë në vijim të ekzekutimit të juridiksionit nga neni 113 i Kushtetutës, si dhe të juridiksionit tjetër të përcaktuar me kushtetutë dhe ligj.[38]

Të shohim në vijim si duket dikotomia e sipërcekur, përkatësisht dikotomia e shpalljes si kushtetuese vs. jo kushtetuese të normave apo ligjeve (si dhe të akteve të tjera juridike) që kanë qenë objekt i kontrollit kushtetues.

15.2.1. Vendimet që nuk gjejnë shkelje kushtetuese

Në praktikën e gjykatave kushtetuese me kontrollin abstrakt të normave juridike (atyre kushtetuese, ligjore apo normave të tjera më karakter të përgjithshëm), në të shumtën e rasteve vendimi është në favor të ruajtjes së aktit të përgjithshëm juridik të sfiduar (apo të pjesëve të caktuara të tij). Kjo nënkupton, për pasojë, refuzimin e kërkesës (**petitum**-it) për shpalljen si jokushtetues të aktit të përgjithshëm (apo pjesëve të caktuara të tij). Vendimet e dhëna në këto raste, konfirmojnë **parimin e prezumimit të**

[38] Cf. neni 20 ["Vendimet"] lidhur me nenet 29 – 54 të kapitullit III [Procedurat e Veçanta] të **Ligjit Nr. 03/L-121** që normon procedurat e veçanta.

kushtetutshmërisë së normave të përgjithshme juridike, të përmbajtura në aktin e sfiduar juridik. Si të tilla, këto vendime kanë fuqi të përgjithshme detyruese (**erga omnes**) në pjesën dërrmuese të sistemeve kushtetuese që i takojnë modelin **evropian/kelsenian**. I tillë është rasti, ta zëmë, me gjykatat kushtetuese të vendeve si vijon: **Republika Çeke**, **Franca**, **Gjermania**, **Hungaria**, **Polonia** dhe **Spanja**. Në këto vende, megjithatë, bëhet dallim i qartë në mes të fuqisë së përgjithshme detyruese (**erga omnes**) të vendimeve dhe cilësisë së tyre të të qenit vendime të ekzekutueshme. Të shohim me radhë si duket kjo, sipas rendit alfabetik.

Në **Kushtetutën e Republikën Çeke** të vitit 1993,[39] nenet e saj 83-89 flasin për Gjykatën Kushtetuese (**GJKÇe**), rolin dhe pozitën e saj në sistemin kushtetues të këtij vendi, si dhe për juridiksionin, natyrën juridike dhe ekzekutimin e vendimeve të saj.

Në nenin 89, i cili ka tri dispozita, flitet për natyrën juridike dhe për ekzekutimin e vendimeve të kësaj Gjykate. Në paragrafin e parë të këtij neni bëhet fjalë për cilësitë e vetekzekutueshme të vendimeve të Gjykatës, duke theksuar se ato bëhen të tilla në momentin e shpalljes së tyre, përveç rasteve kur vetë Gjykata vendos ndryshe. Modalitetet e këtij vetekzekutimi i përcakton më tutje **Ligji për Gjykatën Kushtetuese** i vitit 1993.[40]

Paragrafi i dytë i Kushtetutës thotë se "vendimet e ekzekutueshme të Gjykatës Kushtetuese janë me fuqi të detyrueshme për të gjitha autoritet dhe personat". Sikundër shihet këtu bëhet dallimi i qartë në mes të fuqisë detyruese dhe cilësisë së ekzekutueshme të vendimeve kushtetuese. Paragrafi i fundit, ndërkaq, përcakton se vendimet e Gjykatës me të cilat një traktat shpallet si jo në pajtim me Kushtetutën përbëjnë pengesë për ratifikimin e të njëjtave. Thënë me fjalë të tjera, traktatet e shpallura si jo kushtetuese nuk mund të ratifikohen.

Edhe **Kushtetuta e Francës**[41] ka tri dispozita në një nen, nenin 62, me të cilat rregullohen natyra juridike dhe ekzekutimi i vendimeve të Këshillit Kushtetues (**KKF**). Edhe këtu bëhet qartë në mes të efekteve juridike të vendimeve, të cilat prodhohen si pasojë e cilësisë së brendshme të vendimit, dhe fuqisë së përgjithshme juridike (**erga omnes**). Kështu thuhet në paragrafin e parë të nenit 62, njëri prej nëntë neneve të kreut që normon fizionominë e **KKF**, i cili bën fjalë për ekzekutimin dhe statusin juridik të dispozitave të shpallura jo-kushtetuese: dispozitat e shpallura si jo kushtetuese nuk mund të dekretohen (publikohen) dhe as të implementohen.

Paragrafi në vijim përcakton dy momente të humbjes së efektit të dispozitës së shpallur si jo kushtetuese: ose momenti i shpalljes (publikimit) së vendimit ose momenti tjetër i përcaktuar nga vetë **KKF**. Fjalia e fundit e këtij paragrafi u njeh të drejtën subjekteve të së drejtës që janë afektuar me pasojat juridike të dispozitës së shpallur jo-kushtetuese për të kërkuar anulimin e tyre dhe rikthimin e të drejtave dhe lirive të humbura si pasojë e dispozitave të shpallura si jo kushtetuese. Kushtet dhe kufijtë e kërkesës për anulim të pasojave i përcakton **KKF** me vendimin për anulimin e dispozitave jo kushtetuese.

Paragrafi i fundit është edhe më i qartë se në rastin e sipërme sepse sqaron deri në kufijtë e definimit, gjë që nuk është natyrën e normave kushtetuese, fuqinë detyruese të vendimeve të **KKF**: asnjë vendim i këtij organi nuk mund të apelohet. Kjo nënkupton që ato janë me fuqi të detyrueshme për të gjitha autoritetet publike dhe administrative, si dhe për gjykatat. Në këtë kategori nuk futen personat fizik, por as personat juridik të karakterit të së drejtës private. Kjo është kështu sepse sfidimi dhe shpallja jo-kushtetuese e normave abstrakte në **Francë** bëhet ekskluzivisht në procedurat e **kontrollit incidental** të kushtetutshmërisë, i cili mund të iniciohet vetëm nga ana e dy gjykatave më të larta në vend, **Gjykatës**

---

[39] **Czech Republic's Constitution of 1993 with Amendments through 2002**. Në internet:https://www. constituteproject.org/constitution/Czech_Republic_2002.pdf (shikuar në korrik 2019).

[40] Cf. nenet 58-59 ["Aktgjykimet, Aktvendimet dhe Vendimet "] e **Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Çekisë.** Në internet : http://www.parliament.am/ library/sahmanadrakan%20 dataranner.nor/ch exia.pdf (shikuar në korrik 2019).

[41] **France's Constitution of 1958 with Amendments through 2008**. Në internet: https://www.constitute pr oject.org/constitution/France_2008.pdf?lang=en (shikuar në korrik 2019).

së Kasacionit dhe **Këshillit të Shtetit**, ashtu që afektimi i personave fizik dhe juridik të së drejtës private do të përbënte një padrejtësi të madhe.[42] Këtu bëhet fjalë për kontrollin represiv të normës abstrakte dhe është i vetmi rast në Francë ku parashikohet kontrolli represiv i normave juridike. Kjo është arsyeja, në të njëjtën kohë, se përse Kushtetuta, dhe jo ligji që rregullon jetën dhe punën e **KKF**, përcakton statusin juridik dhe ekzekutimin e vendimeve të dhënë sipas nenit 61.1 (1) të Kushtetutës.

Rasti i **Gjermanisë** është më specifik së të gjitha rastet e sipërme, dhe atë për dy arsye. Arsyeja e parë është se **Ligji Themelor i Gjermanisë** (**LTH**)[43] nuk rregullon natyrën juridike të vendimeve dhe ekzekutimin e tyre. Këtë e bën **Ligji mbi Gjykatën Kushtetuese** (**LGJKGJ**) në nenin 31.[44]Që në dispozitën e parë të tij, neni përcakton se vendimet e **GJKGje** kanë fuqi të përgjithshme detyruese (**erga omnes**) për të gjitha organet kushtetuese federale dhe të **land**-eve, si dhe për gjykatat dhe autoritetet e tjera publike.

Dispozita e paragrafit të dytë të nenit 31 të **LTH** rregullon rastet specifike kur vendimi i Gjykatës ka fuqinë e ligjit. Kjo nënkupton se ekziston dallimi në mes të fuqisë së përgjithshme detyruese (**erga omnes**) të vendimeve dhe rasteve kur vendimi ka fuqinë e ligjit. Kjo e dyta është një efekt specifik i vendimeve, por nuk nënkupton se vendimi i njëjtë nuk ka fuqi të përgjithshme (**erga omnes**). Kjo është kështu sepse këtu bëhet fjalë për përcaktimin e efekteve specifike të vendimeve të caktuara që merren në rastet konkrete. Këtu, në fakt, bëhet fjalë për specifikim të mënyrës së ekzekutimit të vendimeve që kanë të bëjnë me statusin e normave ligjore në sistemin kushtetues gjerman. Në vendet tjera, përfshirë **Kosovën**, kjo mund të rregullohet me vendim të gjykatave kushtetuese.

Në seksionin nr. 17, nenet 39-46 të **Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Hungarisë** (**LGJKH**),[45] që bën fjalë për pasojat ligjore të vendimeve të **Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë** (**GJKHu**), normohet fuqia juridike e vendimeve dhe pasojat e tyre juridike: në ndërkohë që me dy paragrafët e parë të nenit 39 normohet fuqia e përgjithshme detyruese (**erga omnes**) të vendimeve, me paragrafin e fundit normohen ekskluzivisht efektet e tyre specifike për secilin rast konkret. Ato efekte konkrete i përcakton me vendim vetë **GJKHu**, gjithnjë brenda kuadrit kushtetues dhe ligjor.

Sa i përket kuadrit kushtetues, ai gjendet i përcaktuar shumë qartë në nenin 24.3 të **Kushtetutës së Hungarisë,**[46] i cili autorizon **GJKHu** për anulim të normave abstrakte që cenojnë ligjin themelor hungarez. Kuadri ligjor është më specifik sepse nuk flet vetëm për pasojat juridike të vendimeve të Gjykatës në procedurat e kontrollit abstrakt të normës por për të gjitha procedurat, si dhe për llojet e vendimeve të marra në to. Në fakt, janë procedura dhe lloji i saj ato që përcaktojnë efektet juridike të vendimeve të **GJKHu** dhe kjo reflektohet me vendimin e saj meritor (kontroll abstrakt i normës, zgjidhje e konfliktit për kompetencë, kontroll kushtetues i marrëveshjeve ndërkombëtare etj.). Kjo, pra, sikundër shihet, është njëjtë si në **Kosovë**, ku me **Ligjit Nr. 03/L-121** përcaktohen efektet konkrete juridike të vendimeve të marra në procedura të caktuara të veçanta.[47]

Kushtetuta e Polonisë në vetëm një paragraf e bënë të qartë se vendimet e **Tribunalit Kushtetues Polak** (**TKPo**) janë të detyrueshme për të gjithë (**erga omnes**) dhe ndaj tyre nuk mund të ushtrohet

---

42 Neni 61.1 (1) [“Këshilli Kushtetues”] i Kushtetutës së Francës.

43 **Basic Law for the Federal Republic of Germany**, 23 May 1949. Last amended on 13 July 2017. Në internet: https://www.btg-bestellservice.de/pdf/80201000.pdf (shikuar në korrik 2019).

44 “Federal Constitutional Court Act in the version of 11 August 1993 (Federal Law Gazette I p. 1473), last amended by Article 2 of the Act of 8 October 2017 (Federal Law Gazette I p. 3546)”. Në internet: http://www.bundesverfa ssungsgericht.de/SharedDocs/Doënloads/EN/Gesetze/BVerfGG.pdf?blob=publicationFile&v=6 (shikuar në gusht 2019).

45 **Act n. CLI. of 2011 on the Constitutional Court. 22 May 2017. Në internet:** https://hunconcourt.hu/act-on-the-cc/ (shikuar në korrik 2019).

46 **Hungary’s Constitution of 2011**. Në internet: https://www.constituteproject.org/constitution/Hungary_2011.pdf (shikuar në korrik 2019).

47 Kapitulli III [“Procedurat e Veçanta”] i Ligjit Nr. 03/L-121.

apel,[48] në ndërkohë që **Ligji për TKPo** i kushton një kapitull të veçantë materies së ekzekutimit të vendimeve.[49] Ky kapitull, në fakt, bën specifikimin e efekteve konkrete të vendimeve të Tribunalit, në vartësi të procedurave që zhvillohen pranë tij.

Zgjidhjet kushtetuese në **Kushtetutën e Spanjës**[50] dhe të **Ligjit Organik mbi Tribunalin Kushtetues të Spanjës** (**LTKS**)[51] janë shumë interesante sa i përket natyrës juridike dhe ekzekutimit të vendimeve kushtetuese. Në nenin 164, paragrafi i parë, të Kushtetutës bëhet fjalë për fuqinë e përgjithshme detyruese (**erga omnes**) të vendimeve dhe për ekzekutueshmërinë e tyre. Ky nen, në mënyrë shprehimore përcakton se dita e publikimit të vendimeve konsiderohet si moment kur ato konsiderohen **res judicata**, në ndërkohë që fuqi të përgjithshme (**erga omnes**) kanë vetëm vendimet që merren lidhur me kontrollin abstrakt të normës. Sikundër shihet, Kushtetuta bën njëjtësimin e efekteve juridike të **res jurdikata** me fuqinë përgjithësisht të detyrueshme (**erga omnes**) të vendimeve. Se kjo është kështu shihet qartë nga ndërtimi i fjalisë së fundit të paragrafit të parë të nenit 164 të **KS**, në të cilin efektet juridike të vendimeve të Tribunalit të marra lidhur me liritë dhe të drejtat e njeriut kanë vetëm efekt **inter partes**.

Për shkak të historisë së kaluar me gjyqësinë spanjolle, si një gjyqësi konservative që i ka mbajtur anën diktaturës së **Frankos**, në **LTKS** ekzistojnë dispozita që flasin për efektet juridike të vendimeve vetëm sa i përket marrëdhënies së tyre kundrejt gjyqësorit të rregullt: në nenin 38 (1) të **LTKS**, njëjtë si në dispozitën e nenit 5 (1) të **Ligjin për Gjyqësorin e Rregulltë**,[52] në mënyrë shprehimore thuhet se krejt gjyqtarët dhe gjyqësori i rregullt duhet të ndjekin interpretimet e dispozitave dhe parimeve kushtetuese të bëra nga ana e Tribunalit me vendimet e tij meritore të të gjitha llojeve. Në fakt, ligji i fundit në fjalinë e tij të parë thekson se **KS** është norma supreme e sistemit juridik nacional dhe i detyron të gjithë gjyqtarët dhe gjykatat, duke e vënë kësisoj në syprinë fuqinë e përgjithshme detyruese (**erga omnes**) të vendimeve të organit që ka monopol në interpretim kushtetues - **Tribunali Kushtetues (TKSp).**

Kjo si më sipër vlen, **mutatis mutandis**, edhe sa i përket natyrës dhe efekteve juridike të vendimeve të dhëna në procedurat e **kontrollit incidental** të kushtetutshmërisë: në rastet e vendimeve që nuk gjejnë shkelje kushtetuese, fiton prezumimi i kushtetutshmërisë së normave juridike të cilat janë sfiduar përmes procedurave të **kontrollit incidental**. Kjo nënkupton që, në të ardhmen, normat e sfiduara nuk mund të kontestohen sërish nga askush sepse, për nga natyra e tyre juridike, vendimet e marra në procedurat e **kontrollit incidental** kanë fuqi juridike të përgjithshme (**erga omnes**). Pra, njëjtë siç është rasti me vendimet e marra në procedurat e kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë. Kjo është kështu nisur nga fakti se gjykatat kushtetuese në këto procedura nuk vendosin në mënyrë konkrete nëse norma e sfiduar duhet të zbatohet në këtë apo në atë mënyrë, **por duke ngritur vetveten mbi gjendjen faktike në të cilën duhet të zbatohet norma e sfiduar, në mënyrë të njëjtë si te kontrolli abstrakt**. E thënë me fjalë të tjera, kur një gjykatë kushtetuese vlerëson kushtetutshmërinë e një norme juridike apo disa syresh në procedurën e **kontrollit incidental**, atëherë ajo nuk ka parasysh vetëm gjendjen faktike në të cilën është ngritur dyshimi apo bindja mbi jokushtetutshmërinë e normës, por çdo gjendje në të cilën një normë e tillë duhet të zbatohet në të ardhmen. Çdo gjykatë e rregullt apo organ tjetër shtetëror, administrativ apo publik që vjen në situatë për të aplikuar normën e njëjtë në të ardhmen duhet t'i përulet vendimit

---

48 **The Constitution of the Republic of Poland** of 2nd April, 1997. Në internet: https://www. sejm.gov. pl/ prawo / konst/angielski/kon1.htm (shikaur në korrik 2019).

49 **Tribunal Constitutional Act**. 17 October 1997. Articles 59-81 ["Parimet, Procedura e Gjykimit dhe e Zbatimit të Vendiumeve "]. Në internet: https://www.refworld.org/docid/3ae6b53b10.html (shikuar në korrik 2019).

50 **Spain's Constitution of 1978 with Amendments through 2011**. Në internet: https://www.constituteproject. org/ constitution/Spain_2011.pdf?lang=en (shikuar në korrik 2019).

51 **Organic Law 2/1979 on the Constitutional Court**, of 3 October 1919, as amended by the Organic Laws 8/1984, December 26th; 4/1985, June 7th; 7/1988, June 9th; 7/1999, April 21st; 1/2000, January 1st; 6/2007, May 24th; 1/2010, February 19th; 8/2010, November 4th; 12/2015, September 22nd and 15/2015, October 16th. Në internet: https://www.tribunalconstitucional.es/es/tribunal/normativa/Normativa/LOTC-en.pdf (shikuar në korrik 2019).

52 **Organic Law 6/1985, of 1 July, on the Judiciary.** Published in the *Official State Gazette* nº. 157, of 2 July 1985, together with the subsequent modifications up until May 2007. Në internet: https://www.legal-tools.Org /doc/881df4/pdf/ (shikuar në korrik 2019).

të gjykatës përkatëse kushtetuese mbi kontrollin e kushtetutshmërisë së normës juridike konkrete apo disa syresh. Kjo është kështu në pjesën dërrmuese të vendeve që kultivojnë gjyqësi kushtetuese **kelseniane/evropiane** (me përjashtim të **Italisë**, ku në disa raste vendimet e dhëna në kontroll incidental kanë vlerë vetëm në gjykimin ku ka lindur çështja dhe vetëm për gjyqtarin referues; këtu bëhet fjalë për të a. q. **sentenze di rigetto**).

Faktet dhe situatat juridike që përfshihen me çështjen e gjykuar (**res judicata**), të sanksionuar me vendimin e dhënë në procedurë të **kontrollit incidental**, nuk kanë të bëjnë vetëm me gjendjet faktike (rrethanat jetësore) dhe juridike ashtu siç kanë qenë ato kur është dhënë vendimi i tillë: verdikti mbulon dhe vlen për secilën gjendje faktike (rrethanë jetësore) dhe juridike ndaj së cilës gjen zbatim norma që tanimë ka marrë notë pozitive gjatë vlerësimit të kushtetutshmërisë. Nga kjo del se efekti i çështjes së gjykuar (**res judicata**) i vendimit të gjykatës kushtetuese në procedurat e **kontrollit incidental** me të cilin vërtetohet se norma e sfiduar është në pajtim më kushtetutën është i njëjtë me efektin e vendimit të dhënë në procedurat e kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë që kanë verdikt të njëjtë. Në këtë drejtim nuk bën përjashtim as përvoja e **Kosovës**, gjë që shihet më së miri nga formulimi (redaktimi) i verdiktit (pjesës operative) të Gjykatës. Këtu nuk ka rëndësi nëse bëhet fjalë për **aktgjykim** (vendim meritor)[53] apo **aktvendim** (vendim jo-meritor):[54] në dy rastet Gjykata konstaton se norma apo ligji sfiduar është në pajtim me Kushtetutën. Kjo rrethanë më nuk mund të rikontestohet nga askush sepse përbën një çështje të gjykuar (**res judicta**) me fuqi të përgjithshme detyruese (**erga omnes**), sikur të kishte qenë fjala për kontroll abstrakt të kushtetutshmërisë.[55]

Argument shtesë për fuqinë e përgjithshme detyruese (**erga omnes**) të vendimeve si më sipër të gjykatave kushtetuese haset edhe te fakti se secili vendim i marrë në vijim të ushtrimit të juridiksionit të tyre kushtetues duhet të shpallet në gazetën/fletoren zyrtare vendore. Kështu është edhe në **Kosovë**: vendimet e Gjykatës Kushtetuese shpallen në **Gazetën Zyrtare të Kosovës**, njëjtë si normat tjera të përgjithshme dhe të veçanta të autoriteteve shtetërore dhe autoriteteve të tjera

---

53 Cf. *Rasti Nr. KO 04/11. Aktgjykim. Parashtruesi: Gjykata Supreme e Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 35, 36, 37 dhe 38 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme, Nr. 03/L-139*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 01 mars 2012. Nr. ref.: AGJ 203/12: "[…] PËR KËTO ARSYE: Në përputhje me nenin 113.8 të Kushtetutës, nenet 51, 52 dhe 53 të Ligjit, dhe rregullin 75 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese me shumicë: **VENDOSI**: **I**. Që kërkesa është e pranueshme; **II.** Që nenet 35, 36, 37 dhe 38 të Ligjit për shpronësim Nr. 03/L-139, janë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës".

54 Në rastet kur me aktvendim konstatohet se kërkesa është e papranueshme për shkak se pala iniciuese nuk ka arritur mjaftueshëm të argumentoj se ligji i sfiduar apo normat e tij nuk janë jo kushtetuese, atëherë në pjesën operative vetëm konstatohet një gjë e tillë, pra se kërkesa është e papranueshme për shkak se është qartazi e pabazuar. Efekti imediat i këtij konstatimi është se ligji i sfiduar apo normat e tij janë kushtetuese ashtu që sit ë tilla vazhdojnë jetën e tyre siç e kanë nisur që nga moment i parë i jetës sepse mbizotëron prezumimi i kushtetutshmërisë i konstatuar dhje legjitimuar me vendim të Gjykatës. Ky efekt, megjithatë, nuk reflektohet në verdikt (në pjesën operative) të Gjykatës : një gjë e tillë nënkuptohet sepse vetë fakti që Gjykata refuzon një kërkesë si qartazi të pabazuar ka për pasojë që ligji i sfiduar apo normat e tij ngelin në fuqi si pasojë e vazhdimit të jetës së pandërprerë të **prezumimit të kushtetutshmërisë** së nisur me ditën e hyrjes në fuqi, përkatësisht me ditën e nisjes së zbatimit të ligjit apo të normave të tij juridike (të cilat janë sfiduar në procedurën e **kontrollit incidental**). Cf. *Rasti K0 126/16. Gjykata referuese: Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. OS/L-120 për Trepçën*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtine, me 30 maj 2017. Nr. ref.: RK 1086/17 :
"[…] **PËR KËTO ARSYE :** Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës, me nenet 51, 52 dhe 53 të Ligjit dhe me rregullat 36 (2) (d) dhe 75 të Rregullores së punës, më 27 mars 2017, njëzëri **VENDOS : I.** TA DEKLAROJE kërkesën të papranueshme; **II.** T'UA KUMTOJE këtë vendim palëve; **III**. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe **IV**. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë."

55 Në rastet e kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë, kur Gjykata Kushtetuese gjen se kërkesa e palës është qartazi e pabazuar, atëherë në verdiktin e saj konstaton se ligji apo norma është në pajtim më Kushtetutën. Kjo është ngjashëm me **sentenze di rigeto** të së **drejtës italiane**, të cilat i diskutojmë më vonë në këtë kapitull. Cf. *Rasti K0 118/16. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Slavko Simic dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. OS/L-120 për Trepçën*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtinë, më 31 tetor 2016. Nr. rcf.: RK 986/16:
"[…] Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.5 të Kushtetutës, nenit 27 dhe nenit 42, paragrafi 1.3, të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (d) dhe (2) dhe 55 (4) të Rregullores së punës, më 19 tetor 2016, njëzëri VENDOS […] II. TË SHPALLË që Ligji nr. 50/L-120 për Trepçën është kushtetuese për nga përmbajtja dhe për nga procedura e ndjekur për miratim nga Kuvendi i Republikës së Kosovës."

publike.[56] Kjo do të thotë se dispozitat kushtetuese që përmbajnë norma, parime dhe vlerave kushtetuese dhe të cilave iu referohet vendimi mund të zbatohet vetëm sipas udhëzimeve kuptimore të dhëna me vendim nga **Gjykata Kushtetuese** dhe në asnjë mënyrë tjetër. E vetmja mënyrë për të ndryshuar ky interpretim i dhënë me vendimin e Gjykatës është nxjerrja e një norme tjetër juridike me fuqi të njëjtë si ajo që është shpallur si jo kushtetuese, gjithnjë duke u bazuar në prezumimin se norma e re e nxjerrë më pastaj është në pajtim (harmoni) më Kushtetutën. Kjo vlen në veçanti me amendamentet kushtetuese, nisur nga fakti se natyra e tyre juridike është e njëjtë më atë të normave të tjera ekzistuese kushtetuese dhe, zakonisht, hyjnë në fuqi ditën e votimit të suksesshëm të tyre nga ana e përfaqësuesit të sovranit – parlamentit nacional.

Nga kjo që u tha më sipër, megjithatë, në praktikën e huaj ekzistojnë disa përjashtime. Kështu, ta zëmë, në **Belgjikë**, vendimet e Gjykatës Kushtetuese të dhëna në procedurat e **kontrollit incidental** nuk kanë efekt të përgjithshëm (**erga omnes**), por detyrojnë vetëm gjyqtarin që ka ngritur çështjen e kushtetutshmërisë së normës dhe për gjykatat tjera që duhet të vendosin në apel të njëjtën çështje. Ky është një lloj i efektit **inter partes** të vendimit. Në rastin e **Kosovës** dhe në pjesën dërrmuese të vendeve evropiane, ndërkaq, efekti **erga omnes** prekludon (përjashton) palën dhe gjyqtarët në të ardhmen nga ngritja e vlerësimit te kushtetutshmërisë së normës së njëjtë, ani se mund të ndryshojë baza e kualifikimit juridik të natyrës së jokushtetutshmërisë së supozuar: çdoherë, sikundër u pa, mbizotëron **parimi i prezumimit të kushtetutshmërisë së normës që ka kaluar testin e vlerësimit të kushtetutshmërisë nga gjykata përkatëse kushtetuese**. Ajo çfarë ka rëndësi, njëjtë si në rastin e **Kosovës** dhe të vendeve të tjera evropiane të modelit kelsenian, lidhet me faktin se, kur gjykatat kushtetuese gjatë **kontrollit incidental** shpallin se një normë apo ligj nuk është në pajtim me kushtetutën, atëherë vendimi i tyre publikohet në gazetë/fletore zyrtare nacionale si një normë jo kushtetuese ashtu që më nuk mund të figuroj në mesin e normave të vlefshme të sistemit juridik.

Përveç **Belgjikës**, një lloj përjashtimi ekziston edhe në **Itali**, por shumë më ndryshe dhe në një mënyrë të kufizuar. E kemi fjalën për rastin e vendimeve që refuzojnë kërkesën për rrëzim (anulim) të normës apo të ligjit si tërësi. Këto njihen, siç kemi thënë më lartë në këtë seksion, si **sentenze di rigetto**, të cilat kanë fuqi detyruese vetëm ndaj gjyqtarit, palëve dhe ekskluzivisht kanë të bëjë me bazat e jokushtetutshmërisë ashtu siç janë pohuar (pretenduar) nga gjyqtari/gjykata referuese. Rikujtojmë këtu se këto aktgjykime refuzojnë kërkesën e gjyqtarit referues për të shpallur si jokushtetues një normë apo një ligj, të cilat duhet të zbatohen nga ana e gjyqtarit/gjykatës referuese, duke e lënë kështu krejt të paprekur tekstin e normës apo ligjit të sfiduar nga ana e gjyqtarit/gjykatës së rregullt.[57]

Nga kjo që u tha deri këtu, pyetja që shtrohet është si vijon: duke vendosur për të lënë në fuqi normën/normat e sfiduara, a nënkupton kjo që ligji është spastruar në tërësi nga të metat e tij të natyrës kushtetuese dhe më nuk mund të sfidohet? E lidhur ngushtë me këtë është edhe pyetja tjetër: a ka mundësi që të ruhet norma juridike apo ligji përkundër vendimit të gjykatës kushtetuese me të cilin konstatohet se në të ekzistojnë të meta kushtetuese, përkatësisht se norma apo ligji nuk është në pajtim më kushtetutën?

Sa i përket pyetjes së parë, përgjigja është negative: norma/ligji i sfiduar njëherë ka mundësi të sfidohet sërish në një procedurë tjetër por vetëm mbi baza të tjera të reja faktike dhe juridike. Po ashtu, **argumentum a contrario**, është e mundur që të bëhet kontrolli i kushtetutshmërisë së normave të tjera juridike nga i njëjti ligj: kjo situatë mund të lind, ta zëmë, si pasojë e ndryshimit në ndërkohë të juridiksionit të

---

[56] Në disa vende përcaktohet se bëhet shpallja vetëm e verdiktit, pa arsyetim. Mirëpo, standardi është që të bëhet botimi i plotë i vendimeve të gjykatave kushtetuese, përfshirë mendimet mospajtuese dhe konkurruese. Ky standard zakonisht specifikohet deri në detaje në ligjet që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e gjykatave përkatëse kushtetuese (ligjet organike/institucionale).

[57] Cf. më shumë për këtë në "Il quadro delle tipologie decisorie nelle pronunce della Corte costituzionale", botuar në QUADERNO PREDISPOSTO IN OCCASIONE DELL'INCONTRO DI STUDIO CON LA CORTE COSTITUZIONALE DI UNGHERIA Palazzo della Consulta, 11 giugno 2010 a cura di M. Bellocci e T. Giovannetti (pjesa: 2. Le decisioni di merito. 2.1. Le decisioni di rigetto (infondatezza o manifesta infondatezza della questione). Në internet: https://www. cortecostituzionale.it/ documenti/ convegni_ seminari/ STU% 20219 Tipologiadecisioni.pdf (shikuar më 17 korrik 2019).

gjykatës kushtetuese respektive, duke ia njohur asaj të drejtën për kontroll abstrakt represiv, të cilën më herët nuk e ka pasur (një situatë e tillë mund të lind në **Francë**, ku **KKF** nuk ka pasur të drejtën e kontrollit abstrakt represiv të normave juridike; të drejtën për kontroll represiv **in concreto**, në procedurat e **kontrollit incidental**, ky organ e ka fituar në prill të vitit 2010; kontrolli incidental mund të iniciohet vetëm nga dy instancat më të larta të gjyqësorit në **Francë**). Kjo nënkupton se ligjet dhe aktet e tjera juridike të përgjithshme që eventualisht kanë qenë objekt i kërkesës për kontroll të kushtetutshmërisë sipas procedurave të kontrollit preventiv mund të rishikohen sërish, mirëpo tani sipas procedurave të reja të kontrollit represiv, gjithnjë me kusht që miratimi i tyre ka rezultuar në ndryshimin, plotësimin apo prekjen e caqeve origjinale që kanë qenë objekt i kontrollit preventiv.

Lidhur me pyetjen e dytë, ndërkaq, vlen të theksohet se, siç kemi folur më herët në fillim të këtij seksioni, thuajse të gjitha gjykatat kushtetuese në **Evropë** dhe gjetiu kryejnë interpretime kushtetuese që janë konform kushtetutës (**constitution – confirm interpretation**). Në fakt, ky lloj interpretimi apo kjo metodë pune e gjykatave kushtetuese nuk gjen vend vetëm në praktikën e gjyqësisë kushtetuese **evropiane/kelseniane,** por edhe në vendet e **sistemit të së drejtës së përgjithshme**, të cilat nuk kanë gjykatë të ndarë kushtetuese (këtë funksion e luan gjykata më e lartë në vend).[58]

Në rastet e vendimeve të tilla, gjykatat nuk lënë pa konstatuar të metat apo problemet kushtetuese të normës juridike apo ligjit, mirëpo nuk bëjnë anulimin e tyre. Në vend të kësaj, gjykatat japin interpretimin e dispozitave me të meta/probleme kushtetuese në mënyrë që të njëjtat të kthehen në pajtim me kushtetutën nacionale. Kjo nënkupton se, në të ardhmen, gjykatat e rregullta dhe autoritetet e tjera shtetërore, administrative dhe publike kanë për detyrë që të zbatojnë normat apo ligjet që kanë qenë objekt kontrolli kushtetues sipas rezervave të interpretimit të elaboruara në vendim të gjykatës përkatëse kushtetuese. E thënë me fjalë të tjera, në rastet kur gjykatat kushtetuese vendosin për të ruajtur normën apo ligjin e sfiduar, duke vënë si kusht që leximi i saj/tij me rastin e zbatimit të bëhet ekskluzivisht sipas rezervave kushtetuese të shprehura në vendimin e gjykatës kushtetuese, të njëjtat nuk anulohen por ngelin në gazetën zyrtare si pjesë e rendit ekzistues juridiko-kushtetues. Mirëpo, norma apo ligji ka vlerë vetëm së bashku me rezervat e shprehura gjatë interpretimit të gjykatës së dhënë kushtetuese dhe çdo zbatim i tyre duhet të merr parasysh rezervat në fjalë.

Ky lloj i vendimeve, po ashtu ka efekt të përgjithshëm (**erga omnes**), nisur nga fakti se qëllimi primar i ruajtjes së normës juridike/ligjit nga anulimi nuk bëhet për të akomoduar interesat parciale të ligjvënësit **per se**, por me qëllim të respektimit të autoritetit të ligjvënësit dhe të parimit të ndarjes së pushteteve. Ky respektim i ligjvënësit bëhet duke kufizuar efektet jo kushtetuese që do të mund të prodhonte norma apo ligji i kontestuar sikur të zbatohej ashtu siç është miratuar dhe shpallur. Me futjen e rezervave në interpretim të normës apo ligjit që është objekt i kontrolli kushtetues, gjykatat kushtetuese nuk ndërhyjnë në efektet e përgjithshme (**erga omnes**) të vendimeve të veta. Krejt çfarë ndodh këtu është se norma apo ligji vihet brenda parametrave relevantë që masin (vlerësojnë) kushtetutshmërinë ashtu që zbatimi i tyre në të ardhmen të mund të prodhojë pasoja tërësisht kushtetuese ndaj të gjithëve dhe në çdo situate në të ardhmen.

Situatë e ngjashme na paraqitet edhe tek **vendimet e gjykatave kushtetuese**, që nuk janë të rralla, **me të cilat shtyhet në kohë efekti i jo kushtetutshmërisë së gjetur**: ka raste kur gjykatat kushtetuese konstatojnë jo kushtetutshmërinë e një norme apo ligji, ose disa syresh, si dhe të ligjit marr si tërësi, mirëpo vendosin të shtyjnë efektet kohore të këtij konstatimi. Kjo shtyrje bëhet me qëllim që, në ndërkohë, t'i jepet një afat ligjvënësit për të sjellë në harmoni me kushtetutën normën apo ligjin e konstatuar si jo kushtetues. E kemi fjalën këtu për praktikën gjyqësore **gjermane**[59] dhe **italiane.**[60] Këto dy vende, në këtë kuptim,

[58] I tillë është, ta zëmë, rasti i **Kanadasë**. Cf. më shumë në Hugo Cyr and Monica Popescu, "The Supreme Court of Canada". Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 154-198 në fq. 163-167.

[59] Michaela Hailbronner and Stefan Martini, "The German Federal Constitutional Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq 356-393.

[60] Tania Groppi and Irene Spingo, "The Constitutional Court of Italy". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 516-559.

nuk janë vetëm sepse ekzistojnë praktika të njëjta, si në **vendet e sistemit kontinental** (**civil**) që kanë gjykatë të ndarë kushtetuese të **modelit kelsenian**,[61] ashtu edhe në vendet tjera të sistemit të së **drejtës së përgjithshme**, të cilat nuk kanë një gjykatë të ndarë kushtetuese, por këtë funksion e ushtron gjykata më e lartë në vend.[62] E përbashkëta e të gjitha praktikave si më sipër është se, në këto raste, gjykatat kushtetuese konstatojnë jo kushtetutshmërinë e një norme/ligji, por nuk pason anulimi i tyre, duke i dhënë një afat të caktuar ligjvënësit për të fiksuar (ndrequr) jo-kushtetutshmërinë e konstatuar me vendim të gjykatës kushtetuese (ose gjykatës tjetër të barasvlershme me te).

Një modalitet shumë i ngjashëm me këtë ekziston edhe në **Kanada**: **Gjykata Supreme e Kanadasë** (**GJS-Ka**) mund të konstatoj se një normë/ligj është problematik në aspektin kushtetues por, në vend që ta anuloj, ajo vendos për të bërë një lexim të ngushtë (**reading down**) me qëllim që norma apo ligj të sillet në harmoni me Kushtetutën. E kundërta e kësaj është teknika e interpretimit e njohur si leximi i gjerë (**reading in**), ku **GJSKa** vendos që normën apo ligjin e kontestuar ta lexojë sa më gjerë që të jetë e mundur në mënyrë që në te të përfshihen elementet kushtetuese që janë përjashtuar nga teksti i normës apo ligjit me rastin e miratimit të saj/tij nga **Parlamenti i Kanadasë**.[63]

Arsyeja pse kemi veçuar **Gjermaninë** dhe **Italinë** ka të bëjë kryesisht me faktin se këto dy vende i kanë gjykatat kushtetuese ndër më të vjetrat dhe ndër më të suksesshmet në botë, gjë që shihet nga fakti se përvoja e tyre paraqet një përvojë që më së shumti është reprodukuar në katër anët e botës. Ka edhe një arsye tjetër shtesë pse kemi përzgjedhur këto dy vende: në to ekziston një praktikë e rrallë kur gjykatat konstatojnë, jo vetëm si më sipër, **por edhe se një normë apo ligj gjendet në kufijtë e të qenit jo-kushtetues**, duke i dhënë ligjvënësit një afat për të intervenuar sa më shpejt që të jetë e mundur për të ndrequr gjendjen jo kushtetuese në ardhje të një norme/ligji. Deri të nxirret norma apo ligji i ri, situata cilësohet si **gjendje e përkohshme kushtetuese**, përkatësisht gjendje që konsiderohet si kushtetuese, ani se në fakt e tillë nuk është. Kjo gjendje zgjat deri në afatin e dhënë nga gjykata kushtetuese për ndreqjen e jo kushtetutshmërisë në ardhje, e cila është evidentuar me vendim të saj. Kësaj praktike të këtyre dy vendeve i dedikohen rreshtat në vijim, praktikës në të cilën, në njërën anë, **konstatohet jo-kushtetutshmëria ekzistuese por nuk vjen deri te anulimi i normës apo ligjit** dhe, në anën tjetër, **situata e tillë jo-kushtetuese cilësohet si diçka që vjen, që pritet të ndodhë por akoma nuk ka ndodhur**, gjithnjë në funksion të sinjalizimit me kohë të ligjvënësit për një gjë të tillë në mënyrë që ai të ketë kohë dhe mundësi për ta ndrequr gjendjen e tillë në ardhje.

Në **Gjermani**, kjo teknikë për herë të parë është përdorur në vendimin e **GJKGje** për rastin lidhur me ligjin për krahinën **Saar**. Në këtë rast, i vendosur në vitin 1955, ajo kishte ardhur deri te konstatimi se ligji kishte të meta dhe probleme serioze kushtetuese, mirëpo nxjerrja e tij kishte qenë një hap në drejtim të duhur dhe, si i tillë, ai nuk duhej anuluar për shkak se më mirë ishte një ligj i tillë se situata **status quo ante**.[64] I ngjashëm me këtë rast ka qenë edhe një tjetër nga vitit 1961, që ka pasur të bëjë me kufijtë e zonave zgjedhore: në këtë rast, **GJKGje** tha se jo kushtetutshmëria e ligjit me të cilin caktoheshin zonat zgjedhore duhej toleruar për shkak të moskrijimit të vakumit juridik dhe pasojave të rënda për procesin zgjedhor që do të shkaktonte anulimi i tij dhe për shkak të kaosit të pashmangshëm që do të pasonte. Për

---

61 Kështu është rasti, ta zëmë, edhe me Austrinë. Cf. Conrad Lachmayer, "The Austrian Constituional Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq.75-114.

62 Conrado Hübner Mendes, "The Supreme Federal Tribunal of Brazil". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq 115-153.

63 Hugo Cyr and Monica Popescu, "The Supreme Court of Canada", fq. 163-164.

64 Cf. Rasti **BVerfG 4, 157 Saarstatut** (1955). Kjo qasje ka qenë jetike për shkak se federalizmi gjerman në këtë kohë ka qenë ende fragjil dhe ndërhyrja kreative e **GJFGJe** me vendimmarrjen e saj në favor të ndërtimit dhe fuqizimit të një federate gjermane stabile ka qenë i domosdoshëm; jo vetëm kaq, por rikthimi i territorit të Saar nën juridiksionin dhe sovranitetin gjerman ka qenë vendimtar për ruajtjen e sovranitetit nacional të këtij vendi. Cf. më shumë në Elizabeth Wiskemann, "The Saar Moves toward Germany" *Foreign Affairs* Vol. 34, No. 2 (January, 1956), fq. 287-296; Ralf Rogoëski and Thomas Gaëron, "Constitutional Litigation as Dispute Processing: Comparing the U.S. Supreme and the German Federal Constitutional Court". Në Ralf Rogowski and Thomas Gawron (eds.), *Constitutional Courts in Comparison: The U.S. Supreme Court and the German Federal Constitutional Court* (Berghan Books: New York and Oxford, 2002) fq. 1-24 në fq. 4.

të penguar një gjë të tillë, u përdor terminologjia e sofistikuar që thoshte se ligji ende nuk kishte arritur fazën e jo kushtetutshmërisë, por që mund të arrinte në një gjendje të tillë në të ardhmen nëse **Bundestagu** nuk ndryshonte të njëjtin në drejtimin e shënuar në vendim nga **GJKGje.**[65] Një qasje e tillë si kjo, më vonë, në vitin 1975, u konfirmua me një vendim tjetër që prononcohej mbi jo kushtetutshmërinë e përkohshme të një ligji, por që tani për arsye tjera: ndryshimi i parimeve dhe vlerave shoqërore kërkonte rishikimin e ligjeve të vjetra që binin ndesh me këto vlera e parime të reja shoqërore. Këto fjala ka qenë për njohjen e të drejtës për pension të bashkëshortit mashkull të ngelur gjallë.[66] Ky vendim në literaturë komentohet në kuadër të trajtesave për barazinë gjinore në Gjermani, ku roli i **GJKGje** ka qenë shumë i madh.[67]

Në tri situata si më sipër, vendimet e **GJKGje** janë të detyrueshme **erga omnes** dhe duhet të vihen në jetë në mënyrë të njëjtë si vendimet që anulojnë ligjin apo normën juridike me efekt imediat. I vetmi dallim është në terminologji: këtu bëhet fjalë për **kushtetutshmëri të përkohshme**, përkatësisht për vendim që thotë se norma juridike apo ligji vlen deri në nxjerrjen e normës apo ligjit të ri me të cilën ndreqet jokushtetutshmëria e konstatuar me vendim, në ndërkohë që në rastin klasik të konstatimit të jokushtetutshmërisë vie deri të anulimi imediat i normës apo ligjit të gjetur në mospajtim me **LTH**. Në rastet e **kushtetutshmërisë së përkohshme**, shihet qartë, bëhet fjalë për një modalitet të **aktivizimit gjyqësor**, ku përdoret teknika si më sipër juridike e shtyrjes së anulimit të normës apo të ligjit jokushtetues deri në një kohë të caktuar. Ajo që çon peshë këtu, është se në këtë rast, vendimi është i detyrueshëm **erga omnes**, për të gjithë, në ndërkohë që efektet konkrete të përmbajtjes së vendimit, të drejtat e detyrimet që përcakton ai, vihen në lëvizje dhe bëhen operative pas skadimit të afatit të **kushtetutshmërisë së përkohshme**, moment në të cilin vjen deri te anulimi i normës, përkatësisht i ligjit jo kushtetues.

Në praktikën gjyqësore **italiane**, po ashtu ekziston teknika e interpretimit si më sipër, përkatësisht teknika e **kushtetutshmërisë së përkohshme** të normës/ligjit të kontestuar. Në mënyrë të njëjtë dhe për shkaqe të njëjta si në Gjermani, **Gjykata Kushtetuese Italiane** (**GJKIt**) ka vendosur standardin e kushtetutshmërisë së përkohshme në vitin 1982: me një vendim të saj për vlerësimin e kushtetutshmërisë së një ligji për zgjatjen maksimale të mbajtjes në paraburgim (**mbajtje preventive/paraburgim preventiv**, siç e quajnë italianët) në rrethanat e gjendjes së jashtëzakonshme. Në këtë rast, Gjykata tha se ky ligj gëzonte legjitimitetit të caktuar kushtetues për aq sa ishte nxjerrë me qëllim të mbrojtjes së rendit demokratik dhe të sigurisë publike nga aktet terroriste. Kjo gjendje, megjithatë, sipas vlerësimit të **GJKIt** nuk duhet të jetë e përhershme dhe, për pasojë, paraburgimi preventiv duhet të zgjaste sa më shkurt që të ishte e mundur. Në të njëjtën kohë, vendimi i dha një afat të caktuar ligjvënësit italian për të bërë reforma adekuate për tejkalim të gjendjes së konstatuar jo kushtetuese. Për dallim nga rasti gjerman, në këtë rast është vendosur për anulim të ligjit me një vendim tjetër

---

65 Cf. **Rasti i distrikteve elektorale II, BVerfG 16, 130** (1963). Në këtë rast, **GJKGJe** kishte përcaktuar kufijtë e zonave zgjedhore më një saktësi matematikore. Jo kushtetutshmëria e caktimit të kufijve zgjedhorë nuk ka qenë shumë e qartë ditën e mbajtjes së zgjedhjeve sipas ligjit të ri, aq sa për të çuar Gjykatën në përfundimin se bëhej fjalë për ligj jo kushtetues ditën ku po vendoste për rastin. Kjo do të thotë se, sikur të shpallje ligji sipas të cilit ishin mbajtur zgjedhjet jo-kushtetues, atëherë do të pasonte një kaos i madh. Për këtë arsye, vendimi specifikonte se si duheshin evituar, në të ardhmen, të metat kushtetuese të ligjit të tillë. Cf. më shumë për komente në John G. Lexa, "Equality of Franchise under Proportional Representation". *The American Journal of Comparative Law* Vol. 15 No. 3 (1966 - 1967), fq. 478-499; Donald P. Kommers, "Building Democracy: Judicial Review and the German *Rechtsstaat*". John Shannon Brady, Beverly Crawword and Sarah Elise WSiliarty (eds.), *The Postwar Transformation of Germany: Democracy, Prosperity and Nationhood* (The University of Michigan Press: Michigan, 1999) fq. 94-121 në fq. 98; Donald P. Kommers, "The Federal Constitutional Court: Guardian of German Democracy" *The Annals of the American Academy of Political and Social Science.* Law, Society, and Democracy: Comparative Perspectives. Vol. 603 (January 2006), fq. 111-128.

66 Cf. Rasti **BVerfG 39, 169** (1975). (në këtë vendim, **GJKGJe** udhëzon ligjvënësin që të gjejë një metodë më të drejtë që deri në vitin 1984 të bëhet bartja te burri i mbetur gjallë të së drejtës së gruas për pension).

67 Cf. më shumë në shkrimin Dieter Giesen, "Sex Discrimination in Germany (W)". *The Modern Law Review* Vol. 41 No. 5 (Sep., 1978), fq. 526-543.

të veçantë, i njohur si **doppia pronuncia**, përkatësisht si vendimi i dytë, të cilin **GJKIt** e jep çdoherë sipas kërkesës së përsëritur për vlerësimin e kushtetutshmërisë së normës/ligjit të konstatuar herën e parë si jo kushtetues.[68]

Cilësimi i normës/ligjit të sfiduar si kushtetues, por vetëm përkohësisht, mund të duket sikur i shërben respektimit të **parimit të prezumimit të kushtetutshmërisë së ligjeve** dhe të **sigurisë juridike**. Kjo duket kështu vetëm nga jashtë sepse, në fakt, e tillë nuk është: parimi i **prezumimit të kushtetutshmërisë së ligjeve** respektohet, së bashku me dinjitetin e ligjvënësit, vetëm atëherë kur me një saktësi të madhe tregohen problemet kushtetuese të normës/ligjit të sfiduar, duke caktuar me vendim, në të njëjtën kohë, një afat se deri kur mund të ngelet në fuqi norma/ligji me defekte kushtetuese. Ky caktim i afatit mund të shërbejë si një lloj koncesioni ndaj ligjvënësit, pa prekur dinjitetin e tij. Kjo, megjithatë, nuk ndodhë shpesh në praktikë (te italianët, siç e pamë, duhet kërkesë e re për të anuluar normën/ligjin jo kushtetues), ashtu që ligjvënësi vetvetiu inkurajohet për t'u bërë përtac: vendimet me kushtetutshmëri të përkohshme përligjësojnë pritjen e pafund të ligjvënësit për të ndrequr gjendjen jo kushtetuese të vërejtur nga gjykata e dhënë kushtetuese me rastin e parë. Një gjë e tillë, për pasojë, rrënon edhe parimin e sigurisë juridike sepse subjektet e së drejtës nuk janë të sigurt për atë se në çfarë mënyrë duhet t'i përshtatin sjelljet e tyre në të ardhmen, nisur nga fakti se ligji ende ngelet në fuqi, në veçanti nëse gjykata respektive kushtetuese nuk ka caktuar një afat se deri kur mund të vlejë kushtetutshmëria e përkohshme. Shih për këtë arsye, kjo teknikë e interpretimit nuk zbatohet mjaft shpesh, siç është vërejtur në literaturën juridike me shumë të drejtë.[69]

15. 2. 2. Vendimet që gjejnë shkelje kushtetuese dhe modalitetet e menaxhimit të pasojave juridike të gjetjeve të tilla

Vendimet që gjejnë shkelje kushtetuese janë, në fakt, një **modus operandi** standard i gjyqësisë kushtetuese **kelseniane/evropiane**: sikundër dihet, gjykatat kushtetuese kanë lindur si përgjigje ndaj cilësisë normative që kushtetutat kanë fituar me kalimin e kohës, me qëllim të sigurimit të një statusi superior (epërsi) të vlerave, parimeve dhe normave kushtetuese kundrejt vlerave, parimeve dhe normave të tjera juridike. Forma e parë e manifestimit të këtij aktiviteti të gjykatave kushtetuese ka qenë sjellja e tyre si **ligjvënës negativ**, siç e kemi thënë më herët, shprehje kjo e përdorur për herë të parë nga **Hans Kelsen**, arkitekti ideor i gjyqësisë kushtetuese. Me kalimin e kohës ka ardhur deri te pasurimi i formave të veprimit të gjykatave kushtetuese, të cilat tejkalojnë konceptin origjinal të **ligjvënësit negativ**. Këto forma të reja të manifestimit të aktivitetit primar të gjykatave kushtetuese, aktivitet që zakonisht identifikohet me dihotominë **shkelje kushtetuese - anulim norme/ligji**, kryesisht janë për sa vijon:

- e para, gjetja e shkeljes së normave dhe parimeve kushtetuese me pasojë anulimin imediat të normës/ligjit të sfiduar;
- e dyta, gjetja e shkeljes së normave apo parimeve kushtetuese me pasojë anulimin e normës/ligjit të sfiduar, pa efekt imediat (duke shtyrë anulimin); dhe
- e treta, gjetja e shkeljes së normave dhe parimeve kushtetuese, pa pasur për pasojë anulimin e normës/ligjit të sfiduar.

Tri këto forma manifestimi të aktivitetit primar të gjykatave kushtetuese, megjithatë, nuk janë kaq të thjeshta sa duken: në gjyqësinë kushtetuese bashkëkohore, gjykuar sipas hulumtimeve të bëra, ekzistojnë modalitete të ndryshme të manifestimit të secilës prej këtyre tri formave.[70] Këto modalitete i diskutojmë në nën-seksionet në vijim.

---

68 Cf. *Sentenza 15/1982 of 1 February 1982*. Për komentet e **doppia pronuncia**, cf. më shumë në Gustavo Zagrebelsky & *Valeria Marcenò, Giustizia costituzionale. Parte seconda: Ogetti, procedimenti, decisioni (Il Mulino: Milano, 2018) fq. 221-226;* Michele Francaviglia, " *Il caso del decreto-legge n. 34/2019: dall'emanazione differita alla "doppia" deliberazione*". *OSSERVATORIO COSTITUZIONALE* ("Assoziacione Italiana Dei Costituzionalisti"). Fasc. 3/2019 Data: 4 giugno 2019, fq. 36-42.

69 Maartje de Visser, *Constitutional Review in Europe: A Comparative Analysis*, fq. 312.

70 Cf. më shumë për këtë në Maartje de Visser, *Constitutional Review in Europe: A Comparative Analysis*, fq. 312-324.

15. 2. 2. 1. Gjetja e shkeljes së normave dhe parimeve kushtetuese me pasojë anulimin e normës/ligjit të sfiduar dhe modalitetet e tjera për ndreqjen e jokushtetutshmërisë së gjetur

Kur një gjykatë kushtetuese gjen me vendim se një normë/ligj është jokushtetues, atëherë si rregull ndodh anulimi, me pasojë heqjen e normës/ligjit nga librat zyrtar. Kjo nënkupton se norma/ligji humb çdo efekti juridik. Ky është rasti tipik i manifestimit në mënyrë të dukshme i fuqisë së përgjithshme detyruese (**erga omnes**), të cilën e prodhon vendimi i gjykatës kushtetuese. Kjo është kështu në shumicën e sistemeve juridike perëndimore që kultivojnë gjyqësi kushtetuese kelseniane, siç është rasti, ta zëmë, me vendet si vijon: **Cekia,**[71] **Franca,**[72] **Gjermania,**[73] **Hungaria,**[74] **Italia,**[75] dhe **Polonia**.[76] Fuqia e përgjithshme detyruese, **erga omnes**, zakonisht përcaktohet me kushtetutë e shumë rrallë me ligjin që rregullon funksionimin dhe organizimin e gjykatës kushtetuese apo me akt tjetër juridik. Ka raste, po ashtu shumë të rralla, kur kushtetuta dhe ligji njëkohësisht definojnë fuqinë e përgjithshme, **erga omnes**, si dhe pasojat e tjera të vendimeve të gjykatës kushtetuese.

Në rastet e anulimit të normës/ligjit, vlen një tjetër parim i pashkruar, sipas të cilit gjykatat kushtetuese zakonisht procedojnë me anulimin e dispozitave juridike për aq sa është e nevojshme për të ndrequr gjendjen jo kushtetuese. Vendet e sipër cekura, në të gjitha rastet, autorizojnë gjykatat e tyre që të anulojnë pjesërisht apo në tërësi dispozitat e aktit të kontestuar. Në këtë kategori hyn edhe rasti i Kosovës: neni 29 ["Saktësimi i kërkesës"] të **Ligjit Nr. 03/L-121** përcakton se kërkesa "[…] duhet të specifikoje, *inter alia*, nëse i tërë akti i kontestuar apo pjesë të veçanta të këtij akti konsiderohen të jenë në kundërshtim me Kushtetutën." Kjo dispozitë shtjellohet tutje në rregullin 67.2 ["Kërkesa në pajtim me nenin 113.2 (1) dhe (2) të Kushtetutës dhe neneve 29 dhe 30 të Ligjit"] të **RP**. Kështu veprohet edhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese.[77]

---

71 Neni 89.2 ["Gjykata Kushtetuese"[i Kushtetutës : "Vendimet e ekzekutueshme të Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për të gjitha organet dhe individët". *Czech Republic's Constitution of 1993 with Amendments through 2002.* Në internet: https:// www.constituteproject. org/constitution/Czech_Republic_2002.pdf (shikuar më 26 korrik 2019).

72 Neni 62.1 ["Këshilli Kushtetues"] i Kushtetutës së Francës: "Asnjë ankesë nuk lejohet kundër vendimeve të Këshillit Kushtetues. Ato do të jenë të detyrueshme për autoritetet publike dhe të gjitha autoritetet administrative dhe gjykatat". *France's Constitution of 1958 with Amendments through 2008*. Në internet: https://www.constituteproject. org/ constitution/France_2008.pdf?lang=en (shikuar më 27 korrik 2019).

73 Neni 31.1 [" "] i Ligjit për **GJFGje**: "Vendimet e Gjykatës Kushtetuese Federale janë të detyrueshme për organet kushtetuese të Federatës dhe "land"-eve, si dhe ndaj të gjitha gjykatave dhe autoriteteve publike". *Federal Constitutional Court Act in the version of 11 August 1993 (Federal Law Gazette I p. 1473), last amended by Article 2 of the Act of 8 October 2017* (Federal Law Gazette I p. 3546). Në internet: http://www.bundesverfassungsgericht. de/SharedDocs/Downloads/EN/Gesetze/BVerfGG.pdf?__blob=publicationFile&v=6 (shikuar më 26 korrik 2019).

74 Neni 39.1 ["Pasojat juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese"] i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese: "Përveç nëse ky ligj parashikon ndryshe, vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për çdokënd". *Act CLI of 2011 on the Constitutional Court* [Hungary], 2011. Në internet: https://www.refëorld.org/docid/ 4 c 3 45b5b2. html (shikuar më 29 korrik 2019).

75 Neni 136.1 ["Gjykata Kushtetuese"] i Kushtetutës së Italisë : "Në rastet kur Gjykata shpall një ligj si jo legjitim në aspektin kushtetues, ai ligj pushon të ketë efekt që nga dita që pason publikimin e vendimit". *The Constitution of the Italian Republic*. (Gazzetta Ufficiale 27 dicembre 1947, n. 298). Në internet: http://www.ces.es/ TRESMED/docum/ita-cttn-ing.pdf (shikuar më 29 korrik 2019); Ligji për

76 Neni 190.1 ["Tribunali Kushtetues"] i Kushtetutës së Polonisë : "Aktgjykimet e Tribunalit Kushtetues do të jenë përgjithësisht të zbatueshme dhe do të jenë përfundimtare". The Constitution of the Republic of Poland of 2nd April, 1997. As published in *Dziennik Ustaw* No. 78, item 483. Në internet: https://www.sejm.gov. pl/prawo/ konst/angielski/kon1.htm (shikaur më 29 korrik 2019).

77 *Rasti KO 43/19. Aktgjykim. Parashtrues: Albulena Haxhiu, Driton Selmanaj dhe tridhjetë deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. o6/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 27 qershor 2019. Nr. ref.: 1387/19:
"[…] Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.5 dhe 116.2 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 42 të Ligjit dhe në mbështetje të rregullit 59 (1) (a) të Rregullores së punës, me 13 qershor 2019: **VENDOS …**III. **TË KONSTATOJË**, njëzëri, meqë nenet thelbësore të Ligjit nr. 06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë, nuk janë në pajtueshmëri me Kushtetutën, rrjedhimisht Gjykata shpall të njëjtin, në tërësinë e tij, të papajtueshëm me Kushtetutën".

Kjo qasje që autorizon anulimin e tërësishëm apo të pjesshëm të aktit të sfiduar juridik bëhet gjithnjë me shpresë se një pjesë e aktit të sfiduar mund të vazhdojë jetën autonome, pa e humbur kuptimin dhe arsyetimin e qëllimit fillestar për çka është nxjerr.[78] Kjo ka për synim arritjen e dy qëllimeve: e para, vërtetimin e prezumimit të kushtetutshmërisë së akteve juridike; dhe, e dyta, që lidhet me arsyen e parë, respektimin e vullnetit të sovranit dhe përfaqësuesve të tij për aq sa ai vullnet është derdhur në aktin e sfiduar juridik në mënyrë dhe me substancë kushtetuese. Në rastet kur kjo nuk është e mundur, atëherë vjen deri të anulimi i tërësishëm i aktit të përgjithshëm që përmban normat jokushtetuese. Thënë me fjalë të tjera, arsyeja e anulimit të pjesshëm është për shkak të respektit që kanë gjykatat kushtetuese për ligjvënësin nacional dhe produktet e tij, si një organ me kredenciale demokratike, përkatësisht për t'ia bërë me dije ligjvënësit se anulimi ka ndodhur vetëm për aq sa ka qenë e nevojshme për të evituar pasojat e jokushtetutshmërisë së konstatuar me vendim: respektimi i kredencialeve demokratike të organit ligjvënës nga ana e gjykatave kushtetuese synon ruajtjen të paprekur të produkteve të këtij organi përfaqësues të vullnetit të popullit dhe të qytetarit.

Nga përvoja e gjykatave kushtetuese del se **anulimi i pjesshëm** i normës/ligjit të sfiduar ka shërbyer si shkak për aktivizëm gjyqësor: në mënyrë të ngjashme me **interpretimet në pajtim me kushtetutën**, të diskutuara më sipër, te rastet e **anulimit të pjesshëm** gjykatat kushtetuese në mënyrë efektive bëjnë shërimin e të metave kushtetuese të aktit të sfiduar, gjë që rezulton në amendamentimin e tyre efektiv.

Në mes të dy teknikave të interpretimit si më sipër, megjithatë, ekziston një dallim thelbësor: në rastin e **interpretimit në pajtim me kushtetutën**, ligji ruhet, nuk anulohet, me kusht që t'i përmbahet interpretimit të dhënë nga gjykata kushtetuese, gjithnjë duke respektuar maksimalisht qëllimin fillestar të ligjvënësit. Te rastet e **anulimit të pjesshëm**, ndërkaq, norma/ligji anulohet pjesërisht për aq sa ka të bëjë me situatat e parashikuara në te apo me situata të tjera që gjykata kushtetuese mendon se mund të krijohen në të ardhmen. Një rast i tillë mund të krijohet, ta zëmë, nëse norma/ligji numëron taksativisht **bazat e diskriminimit** duke përjashtuar **bashkësinë jashtëmartesore** ose **bashkësinë e bindjeve të përbashkëta**, ashtu që, në këto raste, gjykata kushtetuese anulon normën/ligjin për aq sa lista e bazave të diskriminimit ngelet fikse, përkatësisht derisa në te nuk të futet edhe **bashkësia jashtëmartesore** ose **bashkësia e bindjeve të përbashkëta** si bazë për diskriminim.[79]

Në literaturë, përvojat **gjermane** dhe **italiane** merren si shembull mjaft shpesh, si përvoja interesante për sa i përket modaliteteve të anulimit të pjesshëm të normës/ligjit.[80] Në fakt, rrallëherë në praktikë paraqitet nevoja për anulim të tërësishëm të normës/ligjit. Kështu është edhe në **Kosovë** dhe në përvojën e saj modeste me gjyqësinë kushtetuese deri më sot. Këtë e pamë më herët në rastin e vendimit për anulimin e Ligjit nr. 06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë.[81]

Në rastet kur ndodhë anulimi, ndërkaq, efekti praktik i vendimit është **ex tunc**. Për të sanuar këtë efekt, gjykatat kushtetuese në këto dy vende kanë sajuar teknika që zbusin dukshëm efektin **ex tunc** dhe pasojat që e shoqërojnë.[82]

Kështu, në vijim si më sipër, në rastin gjerman janë ndërtuar dy forma të modaliteteve të anulimit të pjesshëm si më sipër: **anulimi i pjesshëm kuantitativ** dhe **anulimi i pjesshëm kualitativ.**[83] Në rastin e parë, sikundër mund të imagjinohet nga vetë fjala që e cilëson emrin foljor "anulim", kemi të bëjmë me

---

78 Wolfgang Zeidler, "Federal Constitutional Court of the Federal Republic of Germany: Decisions on the Constitutionality of Legal Norms" *Notre Dame Law Review* Vol. 62 Issue 4 (1987) fq. 504-525 në fq. 508.

79 Ibid., fq. 510-511.

80 Cf. më shumë për këtë në Maartje de Visser, *Constitutional Review in Europe: A Comparative Analysis*, fq. 314-315.

81 Cf. funsnota nr. 77, **supra**, si dhe teksti që e shoqëron.

82 Wolfgang Zeidler, "Federal Constitutional Court of the Federal Republic of Germany: Decisions on the Constitutionality of Legal Norms", fq.

83 Ibid., fq. 509; Cf. edhe Maartje de Visser, *Constitutional Review in Europe: A Comparative Analysis,* fq. 314.

reduktimin e fjalive në një dispozitë të normës juridike apo në një pjesë të aktit të përgjithshëm marrë si tërësi. Këtu, thënë ndryshe, flitet për heqjen e fjalive të caktuara të normës apo të pjesëve të caktuara të aktit të përgjithshëm, heqje të cilat figurojnë në dispozitivin e vendimit me të cilin kryhet anulimi i pjesshëm.[84] Në rastin e dytë, ndërkaq, ndodhë e kundërta: anulimi i pjesshëm bëhet për shkak se norma apo akti i përgjithshëm juridik nuk përmend situatat specifike, të cilat, po të ishin të pranishme në tekst, do ta bënin atë kushtetues, apo për arsye se zbatimi i normës apo i aktit të përgjithshëm ndaj situatave të caktuara është jokushtetues.[85]

Në seksionin e dytë të kapitullit të 14-të kemi folur për lindjen dhe kuptimin e teorisë dhe praktikës italiane të **diritto vivente:** lindja ja e saj ka ndodhur në vazhdën e luftës në mes të gjykatave më të larta italiane, **Gjykatës Supreme të Kasacionit** (**GJSKIt**) dhe **GJKIt**. Kjo e fundit, duke qenë gjykatë e re, në fillim të punës së saj ka hasur në vështirësi të mëdha dhe në rezistencë të **GJSKIt**. Për të krijuar një harmoni në mes tyre, dhe për të siguruar zbatimin e vendimeve të **GJKIt**, kjo e fundit krijoj teknikën e prodhimit të vendimeve të a. q. **sentence interpretative**. Realizimi i një teknike të tillë është bërë e mundur përmes dallimit që ajo e ka krijuar në mes të tekstit kushtetues (**disposizione**) dhe përmbajtjes së tij apo sjelljes që kërkohet nga teksti (**norma**).

Në vijim, si më sipër, në kontekstin e diskutimit për **diritto vivente**, po ashtu kemi vënë në dukje se ekzistojnë dy forma të **sentenze interpretative:** forma e parë quhet **sentenza intepretativa di rigetto,** kurse e dyta **sentenza interpretativa di accoglimento.** Në rastin e formës së parë, **GJKIt** i pranon si kushtetuese interpretimet e **GJSKIt** duke u bazuar në **norma** (përmbajtjen e tekstit), jo në tekstin e **disposizione**, ashtu siç kjo kuptohet në praktikën e konsoliduar gjyqësore të instancës më të lartë gjyqësore në **Itali.** Kjo është njëra prej teknikave mjaft shpesh të përdorura. E kundërta e kësaj është forma e dytë e vendimeve si më sipër: në këto raste, **GJKIt** i pranon si kushtetuese vetëm interpretimin e dhënë nga vetë ajo dhe, për pasojë, e len tekstin e **disposizione** në vend dhe të pandryshuar. Këtu, për dallim nga rasti i parë, nuk pranohen si kushtetuese interpretimet e përmbajtura në **norma** sipas praktikës së konsoliduar të **GJSKIt.** Kjo don të thotë se teksti i dispozitës së shkruar që gjendet në ligj ose akt tjetër juridik të përgjithshëm nuk eliminohet nga sistemi juridik (rrin në gazetë zyrtare).[86] Vetëm lloji i parë i vendimeve paraqesin **diritto vivente**. Kjo ndryshon kur bëhet fjalë për caqet e fuqisë së tyre detyruese.

Shikuar nga perspektiva e fuqisë së tyre detyruese, modalitetet e **sentenza interpretativa** (në dy versionet si më sipër) nuk kanë cilësinë **erga omnes**: në rastet kur pranohet kërkesa kushtetuese te **sentenze interpretativa di accoglimento**, aktgjykimi përfshinë vetëm raportet e ezauruara (përfshira) me te dhe ka efekt vetëm për aq sa ato raporte kanë qenë pjesë përbërëse e normës së krijuar nga **GJSKIt** si **diritto vivente**. Kjo në terma praktikë nënkupton, thënë ndryshe, për sa vijon: lloji i parë i aktgjykimeve, qartë duket, ka fuqi detyruese **inter partes**, kurse aktgjykimet e llojit të dytë e detyrojnë gjyqtarin që ka ngritur çështjen e kontrollit incidental që t'i përmbahet interpretimit të dhënë nga **GJKIt** sa i përket rastit që pret

---

84 Si raste që përmenden janë dispozitat në një normë që për nominim në komitetin e personelit kërkonin nënshkrimet e një të dhjetës së votueseve apo dispozitat e një norme tjetër që për t'u certifikuar si kontabilist i taksave kërkonte nga kandidati që të jep dorëheqje nga shërbimi vendor i administratës tatimore. Cf. Wolfgang Zeidler, "Federal Constitutional Court of the Federal Republic of Germany: Decisions on the Constitutionality of Legal Norms", fq. 509 fusn. nr. 28.

85 Si rast tipik i kësaj gjendje përmendet një rast i vitit 1982, kur Gjykata kishte anuluar pjesërisht dispozitat e një ligji që kushtëzonte regjistrimin në një fakultetet e mjekësisë në mënyrë diskriminuese për ata që kishin të kryer shkollat profesionale ("Fachhochschule") dhe ishin regjistruar në semestrin dimëror të vitit akademik 1974-1975, të cilët kur ishin regjistruar kishin besuar se e kishin të garantuar studimin e mjekësisë në mënyrë të njëjtë si ata që kishin kryer shkollat akademike apo jo profesionale ("Abitur"). Në ndërkohë, pas regjistrimit, grupit të parë të shkollave profesionale iu vu si kusht në vitin 1977 provimi pranues dhe dhënia e disa provimeve pranuese që "në mënyrë të arsyeshme plotësojnë" lëndët kryesore nga lëmi mjekësisë. Cf. Më shumë në Wolfgang Zeidler, "Federal Constitutional Court of the Federal Republic of Germany: Decisions on the Constitutionality of Legal Norms", fq. 509 fus. nr. 29; Maartje de Visser, *Constitutional Review in Europe: A Comparative Analysis*, fq. 314.

86 Giancarlo Rolla & Tania Groppi, "Between Politics and the Law: The Development of Constitutional Review in Italy". Në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective* (Kluwer Law International: The Hague – London – New York, 2010) fq. 143-159 në fq. 150-151.

gjykim dhe vendosje nga gjykata referuese, por vetëm sa i përket normës së krijuar nga **GJSKIt**, pa prekur tekstin e dispozitës ligjore apo të aktit tjetër të përgjithshëm juridik.[87] Kjo do të thotë se te **sentenze interpretative di accoglimento** fuqia e detyruese **erga omnes** shtrihet vetëm ndaj normës, jo ndaj dispozitave që janë në tekst përkatës ligjor apo në akt tjetër normativ të përgjithshëm. Gjyqtari që ka ngritur çështjen nuk guxon të injoroj interpretimin e bërë nga **GJKIt** dhe askush tjetër pas tij, për aq sa norma e gjetur si kushtetuese në kuptimin e **diritto vivente** gjen zbatim të sërishëm në praktikë.[88]

Një lloj tjetër i vendimeve të **GJKIt,** që njihet me emrin **sentenze manipolative**, që në gjuhën shqipe don të thotë **aktgjykime manipulative**, kanë fuqi detyruese **erga omnes**. Kjo është kështu sepse me to një ligj shpallet jo kushtetues dhe, teorikisht, anulohet. E themi teorikisht sepse, në praktikë, siç do të shihet në vijim, ekzistojnë disa modalitete me të cilat shmanget anulimi i ligjit të shpallur jo kushtetues.

Janë disa klasifikime të aktgjykimeve manipulative, ndër të cilat ne i veçojmë për diskutim si vijon:[89] **sentence ablative** (aktgjykimet shkëputëse), **sentenze sosituive** (aktgjykimet zëvendësuese) dhe **sentence additive** (aktgjykimet shtuese). Në ndërkohë që dy llojet e mësipërme, **sentence interpretative di rigetto** dhe **sentenze interpretative di accoglimento**, normohen me Kushtetutë dhe Ligjin për GJKIt, **aktgjykimet manipulative** janë në tërësi produkt i praktikës së pasur gjyqësore, përkatësisht rezultat i **aktivizmit gjyqësor** të **GJKIt**, e cila, për të rregulluar raportet e saj me gjyqësorin me ligjvënësit ka zbuluar modalitete të vendimmarrjes që nuk konsistojnë në anulimin e ligjeve e as në interpretimin e tyre në pajtim (harmoni) me Kushtetutën Italiane. Doktrina italiane këtë gjendje e sheh se rezultat i lëvizjes graduale aktiviste nga kontrolli klasik represiv i normës abstrakte në një interpretim kreativ.[90]

Dy modalitetet si më sipër të **aktgjykimeve interpretative** (**sentence interpretative**), që janë krijuar me norma kushtetuese e ligjore me qëllim rregullimin e marrëdhënieve të **GKIt** me **GJSKIt,** si përfaqësuese e gjyqësorit të rregullt në këtë vend, aktgjykimet manipulative (**sentenze manipolative**) janë krijuar nga nevoja dhe përvoja e gjyqësisë kushtetuese italiane për të rregulluar marrëdhëniet e saj me ligjvënësin, si pasojë e synimit për ruajtjen e dinjitetit të ligjvënësit që përmblidhet në parimin e prezumimit të kushtetutshmërisë së ligjeve. Në ndërkohë që në rastin e parë, vetë kushtetutëvënësi dhe ligjvënësi italian kanë synuar "shpëtimin e fytyrës" gjyqësorit të rregullt, pas rezistimit të tij për të vënë në jetë dispozitat dhe urdhrat kushtetuese, duke e konsideruar Kushtetutën si një akt programatik pa vlerë normative,[91] në rastin e **sentenze manipolative** bëhet fjalë për një kreativitet të punës së **GJKIt** që ka për qëllim "shpëtimin e fytyrës" së ligjvënësit italian. Kjo është kështu për shkak se në gjyqësinë klasike kushtetuese kontrolli represiv ka rezultuar në anulim të ligjit apo normave ligjore çdoherë ku është gjetur se ato janë në kundërshtim me normat, parimet dhe vlerat kushtetuese. Kur anulohet ligji ndodhë, siç e ka thënë një autor, sikur kur **vdes njeriu** dhe më nuk mund të ngjallet.[92] Kjo analogji, gjithnjë sipas këtij autori, nuk është e përshtatshme sepse praktika e gjyqësisë kushtetuese ka krijuar modalitete që tejkalojnë dihotominë **normë jokushtetuese/anulim** dhe **normë kushtetuese/konfirmim i kushtetutshmërisë së normës**.

---

87 Giancarlo Rolla & Tania Groppi, "Between Politics and the Law: The Development of Constitutional Review in Italy", fq. 145.

88 Daniella Biella, *Manipolazione e interpretazione della Corte costituzionale in due sektori emblematici del diritto penale: la giustizia minorile e la giustizia militare* (Universita degli studi di Milano: Milano, 2010/2011) fq. 10-30.

89 Ekzistojnë klasifikime të tjera të aktgjykimeve manipulative. Ne ju kemi përmbajtur klasifikimit të Maartje de Visser, *Constitutional Review in Europe: A Comparative Analysis*, fq. 314-315.

90 Gustavo Zagrebelsky & Valeria Marceno, *Giustizia costituzionale* (Il Mulino: Bologna, 2012), fq. 337-338.

91 Në fillim, në vitet e para pas themelimit të gjyqësisë kushtetuese italiane, është folur për **luftë në mes të gjykatave**, për shkak të mospajtimeve të thella në mes të **GJSKIt** dhe **GJKIt**. Ky konflikt në mes të gjykatave kushtetuese dhe gjykatave më të larta në gjyqësorin e rregullt ka lindur dhe është zhvilluar si pasojë e konstitucionalizimit gradual të legjislacionit dhe jetës në shoqëritë demokratike ku kushtetutat kanë vlerë të theksuar normative, kurse gjykatat kushtetuese luajnë rolin e mekanizmit të tyre zbatues. Cf. më shumë për rastin Italian në Malcolm Evans, "The Italian Constitutional Court". *The International and Comparative Law Quarterly* Vol. 17 No. 3 (July, 1968), fq. 602-663; për situatën përgjithshme në vendet e ndryshme të **Evropës**, përfshirë **Italinë**, por edhe vendet ish-komuniste, cf. më shumë në *Lech Garlicki, "Constitutional corts versus supreme courts". International Journal of Constitutional Law* Vol. 5 No.1 (January, 2007) fq. 44–68 në fq. 54-57.

92 András Jakab, "Two Opposing Paradigms of Continental European Constitutional Thinking: Austria and Germany" *The International and Comparative Law Quarterly* Vol. 58 No. 4 (October 2009) fq. 933-955 në fq. 951-952.

Ky standard si më sipër është ndërtuar gradualisht në vijim të vetëdijësimit të gjyqësisë kushtetuese dhe degëve tjera të pushtetit, në veçanti të ligjvënësit, për deficitin demokratik që ka gjyqësia kushtetuese, por edhe për nevojën e madhe të ligjvënësit dhe pushteteve të tjera të ndara për të zhvilluar jetën e tyre brenda parametrave kushtetues. Në raport me ligjvënësin, kjo gjendje arsyetohet me kujdesin ndaj dinjitetit të tij dhe respektin për sovranin që ai e përfaqëson. Si pasojë e kësaj janë krijuar modalitete e ndryshme të akomodimit të këtij raporti delikat, gjë që shihet me **sentenze manipolative** (aktgjykimet manipulative) në praktikën italiane, temë së cilës i kthehemi sërish në rreshtat në vijim. Para se të bëjmë këtë, në fakt, këtu shënojmë se në **Kosovë** duhet të veçohen dy raste që u ngjajnë **sentenze manipolative** të praktikës italiane: rasti i vendimit lidhur me **Ligjin nr. 03/L- 179 për Kryqin e Kuq të Republikës se Kosovës** dhe vendimi **për rastin Pacolli.**

Në rastin e parë, Gjykata Kushtetuese i ka deklaruar si jo në pajtim me Kushtetutën dispozitat e një ligji kosovar për sigurimet, pa e thënë se efekti i tij do të jetë retroaktiv, gjë që nënkuptohet, ashtu që çdo prestim apo veprim i ndërmarrë në bazë të tij mund të anulohet **ex tunc** në procedurë përkatëse civile sepse vetë dispozitat e normës së ligjit në fjalë janë anuluar me atë efekt,[93] kurse në të dytin Gjykata Kushtetuese ka lënë në fuqi dhe u ka dhënë legjitimitet të plotë kushtetues veprimeve të ndërmarra nga presidenti i zgjedhur në mënyrë jo-kushtetuese, **Behxhet Pacolli**. Kjo është bërë me vetë faktin që vendimi merr efekt menjëherë, konform nenit 116.3 të Kushtetutës, përkatësisht ditën e publikimit, njëjtë si në rastin pararendës të **Ligjit për Kryqin e Kuq**.[94] Kjo për shkak se po të kishte anuluar veprimet ndërmarra nga presidenti i zgjedhur në mënyrë jokushtetuese, atëherë do të ishte dashur të anuloheshin të gjitha nënshkrimet dhe pranimet e letrave kredenciale të ambasadorëve të huaj, marrëveshjet eventuale ndërkombëtare të lidhura me shtetet dhe organizatat tjera dhe kështu me radhë. Kjo do të shkaktonte cenimin e dispozitave kushtetuese që detyrojnë Shtetin e Kosovës në planin ndërkombëtar. Kjo praktikë, siç do të shihet, është shumë e përhapur në **Itali**, siç është edhe në Gjermani, për cka u diskutua më sipër. Këtu shënojmë se rasti **Pacolli** nuk ka të bëj me kontrollin kushtetues të normës abstrakte, por me një vendim të Kuvendit të Kosovës për zgjedhjen e Shefit të Shtetit, vendim që u vlerësua si në kundërshtim me **Kushtetutën e Kosovës**.

Në ndërkohë qe **sentenze interpretative** janë krijuar me norma të qarta kushtetuese dhe ligjore respektive italiane, **sentence manipolative** kanë origjinën në praktikën e pasur të gjyqësisë kushtetuese italiane. Këtë e theksuam më sipër. Të shohim si duket sfondi historik i krijimit të kësaj praktike.

Në dekadat e para të themelimit të **GJKIt** ka pasur nevojë që t'i jepet më shumë fuqi gjyqësorit të rregullt, me norma kushtetuese dhe ligjore, si implememtues direkt i ligjeve të vjetra nga **koha fashiste**, që të reflektojë dhe të vetëdijësohet për nevojën e eliminimit gradual nga sistemi juridik - kushtetues italian të ligjeve dhe dispozitave ligjore arkaike të kohës së **Fashizmit**, jo vetëm në sferën penale por edhe në sferën e të drejtës administrative, familjare, të pronësisë industriale, të taksave dhe kështu me radhë, ligje që rrënonin garancionet themelore kushtetuese mbi lirinë personale, lirinë e shprehjes, rolin dhe pozitën e fesë etj.[95] Për këtë arsye janë krijuar dy llojet e sipërcekura të **sentenze interpretative**: e para, për të

---

93 Rasti është nisur përmes kërkesës për **kontroll incidental**, ashtu që procedura e nisur nga gjykata referuese pushon menjëherë dhe rasti mbyllet, kurse çdo prestim i kryer në bazë të ligjit të vjetër që është shpallur si i pavlefshëm për shkak të jokushtetutshmërisë së tij mund të rikthehet në gjendjen e mëparshme ose të kërkohet kompensimi në procedurë të veçantë civile, ku aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese shërben si fakt. Cf. për aktgjykimin në : *Rasti K0 157/18. Aktgjykim. Parashtrues: Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 14, paragrafit 1.7 të Ligjit nr. 03/L- 179 për Kryqin e Kuq të Republikës se Kosovës*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 28 mars 2019. Nr. ref.: AGJ 1341/19.

94 *Rasti KO 29/11. Aktgjykim. Parashtruesit: Sabri Hamiti dhe deputetë të tjerë. Vlerësimi i kushtetutshmërisë të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, i datës 22 shkurt 2011*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 30 mars 2011. Nr. ref.: AGJ 107/11:
"[…] PËR KËTO ARSYE GJYKATA, në seancën e mbajtur më 28 mars 2011, …. II. SHPALL, me shtatë vota për dhe dy kundër, se Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, me 22 shkurt 2011, është jo-kushtetues dhe nuk do të jetë në fuqi nga data e publikimit të tij në përputhshmëri me nenin 116.3 të Kushtetutës - meqenëse është në kundërshtim me kërkesat e nenit 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe parimet demokratike të mishëruara aty."

95 Malcolm Evans, "The Italian Constitutional Court", fq. 616- 628.

konfirmuar kushtetutshmërinë e ligjeve të vjetra kur ato nuk janë kundërkushtetuese, kurse, e dyta, për të braktisur praktikën e vënies në jetë të ligjeve arkaike fashiste, duke u mbështetur në një **normë të re** të krijuar si **diritto vivente** nga **GJSKiT**, duke injoruar tekstin ekzistues ligjor.[96] Kjo nuk vjen në shprehje në **sentenze manipolative** sepse, thjeshtë, në rastin e tyre, siç e thonë autorët italianë me renome, **manipulimi** i tekstit të normës abstrakte ose i normës (e kuptuar si **diritto vivente**), përbën **transformim** (modifikim) të tyre në vend të eliminimit të të njëjtave nga sistemi juridik-kushtetues ose interpretimit në pajtim me **Kushtetutën Italiane.**[97] Kjo bëhet e qartë nga përmbajtja e tri modaliteteve të sipërcekura të aktgjykimeve manipulative: **sentence ablative** (aktgjykimet shkëputëse), **sentenze sosituive** (aktgjykimet zëvendësuese) dhe **sentence additive** (aktgjykimet shtuese). Këtyre modaliteteve iu kthehemi rreshtave në vijim.

Te **sentenze ablative**, Gjykata bën heqjen apo ndarjen (shkëputjen) e një pjese të dispozitës së normës abstrakte për aq sa vënia e saj në jetë krijon një situatë të caktuar jo kushtetuese, kurse te **sentenze sostitutive**, Gjykata, me qëllim të prodhimit të një rezultati në pajtim me kushtetutën, zëvendëson një dispozitë origjinale të normës abstrakte me një përmbajtje tjetër autonome për shkak se gjatë zbatimit dispozita origjinale mund të jep një rezultat jo kushtetues. Në rastin e fundit të **sentenze adittive**, ndërkaq, Gjykata e shpall jo kushtetues normën abstrakte për aq sa ajo nuk përmban një dispozitë të caktuar, duke e shtuar (futur) vetë në tekst këtë dispozitë të munguar dhe duke plotësuar efektivisht lëshimin e ligjvënësit. Në këto lloj aktgjykimesh, Gjykata vendosë fjalitë që janë të absolutisht të domosdoshme dhe të pashmangshme për shkak të përmbajtjes origjinale të normës abstrakte. Këto quhen vargje të detyrueshme (**rime obbligate**).[98]

Sikundër mund të vërehet nga diskutimi në këtë seksion, **vrasja** e një normë abstrakte nuk nënkupton se ajo nuk mund të **ringjallet**. Përdorëm këtë shprehje figurative me qëllim që t'ia lehtësojmë lexuesit fillestar të kuptuarit e standardeve klasike dhe moderne të kontrollit të kushtetutshmërisë së normave abstrakte (qoftë si tekst juridik i përgjithshëm apo si normë në kuptim të praktikës së etabluar të sjelljes, siç është rasti me **diritto vivente** italiane). Mbi të gjitha, përdorëm këtë eufemizëm për të sqaruar lexuesin tonë se gjykatat kushtetuese jo çdoherë anulojnë një ligj ose pjesë të caktuara të tij (apo të aktit tjetër të përgjithshëm juridik): vendimi i gjykatës përkatëse kushtetuese për anulim mund të përmbajë udhëzime apo qortime për ligjvënësin, të cilat ai duhet t'i marrë parasysh me rastin e draftimit të normës së re në vend të asaj që është anuluar. Udhëzimet e tilla mund të kenë natyrë kohore, ku gjykata i jep një afat të saktë ligjvënësit brenda të cilit ai duhet të përmbushë detyrimin (urdhrin) e dhënë nga gjykata kushtetuese me vendimin e saj për anulim të normës juridike.

Në praktikë, zakonisht gjykatat kushtetuese flasin për "një afat të arsyeshëm" brenda të cilit ligjvënësi duhet të veprojë. Si shembull tipik i këtij pozicioni përmendet një rast nga praktika gjyqësore e **GJK*Çe***, i njohur si **saga e qirave të shtëpive për banim**: qeveria e këtij vendi kishte nxjerrë një dekret me të cilin, njëjtë si në kohën e komunizmit, caktonte qiratë e qiradhënësve në mënyrë administrative, duke shkaktuar pakënaqësi te qiramarrësit për shkak se një praktikë e tillë binte ndesh me vlerën e tregut dhe kriteret tjera të tregut të lirë të qirasë. **GJK*Çe*** shpalli si jo kushtetues këtë dekret dhe i dha urdhër ligjvënësit për të nxjerrë normativën përkatëse për të normuar këtë çështje. Kjo nuk u bë! Pas disa vendimeve tjera të ngjashme, me të cilat **GJK*Çe*** anuloi si jo kushtetuese dekretet qeveritare mbi caktimin e qirave në mënyrë administrative, u vendos që t'i jepet një diskrecion i plotë gjyqësorit të rregullt që gjatë vendosjes së rasteve të tilla lidhur me

---

96 Për një analizë të shkëlqyer të lindjes dhe zhvillimit të të gjitha modaliteteve të vendimeve të **GKIt** dhe marrëdhënien e tyre me gjyqësorin e rregullt dhe ligjvënësin, Cf. më shumë në Gustavo Zagrebelsky & Valeria Marceno, *Giustizia costituzionale* (2012), fq. 337-418.

97 Ibid., fq. 390; Cf. edhe Roberto Romboli, Carmela Salazar, Tania Groppi, Andrea Pertici, Roberto Pinardi and Gianpaolo Parodi, "Il processo costituzionale: la tipologia delle decisioni" *Il Foro Italiano* Vol. 121 No. 3 (Marzo, 1998), fq. 143-166 në fq. 152-156.

98 Maartje de Visser, *Constitutional Review in Europe: A Comparative Analysis*, fq.315; Gustavo Zagrebelsky & Valeria Marceno, *Giustizia costituzionale* (2012), fq. 396-397.

qiranë të merr parasysh udhëzimet e dhëna nga ajo. Ato udhëzime konsistonin në sa vijon: vendimi duhet të merret në pajtim me kushtet tregut lokal të çmimeve të qirasë, duke e argumentuar në mënyrë racionale dhe përmes vlerësimit të peshës së rrethanave të faktit për secilin rast, duke respektuar standardet e parimet e jetës civile, të jetës, të dijes teorike-juridike konform praktikës gjyqësore të vetë **GJKÇe**.[99]

15. 2. 2. 2. Gjetja e shkeljes së normave apo parimeve kushtetuese me pasojë anulimin e normës së sfiduar (apo të ligjit si tërësi), jo me efekt imediat, por duke shtyrë anulimin

Sikundër u pa më sipër, dihotomia **normë jo kushtetuese - anulim** dhe **normë kushtetuese -konfirmim i kushtetutshmërisë së saj** është vetëm një mashtrim sepse në praktikë ekzistojnë gjëra e situata më të ndryshme dhe më të komplikuara që nuk i përshtaten kësaj dihotomie. Aktualisht, gjykatat kushtetuese gjejnë dhe shpallin se një normë abstrakte ose një akt i përgjithshëm juridik është jo kushtetues, duke mos e anuluar atë me efekt imediat, por duke e shtyrë anulimin ose vetë efektet që anulimi prodhon. Kjo teknikë apo kjo qasje e vendimmarrjes në gjyqësinë kushtetuese, megjithatë, përbën një përjashtim. Për të kuptuar më së miri këtë dilemë dhe këtë gjendje, që në fillim duhet të kuptohet rregulli themelor i gjyqësisë kushtetuese, i cili, siç dihet, ka të bëjë me natyrën e saj si **ligjvënës negativ**. Kur një normë shpallet jo kushtetuese, pason anulimi. Ai anulim prodhon efekt **ex tunc**, që nga krijimi normës, përkatësisht që nga miratimi i aktit të përgjithshëm juridik. Këtë standard sot e kultivojnë në mënyrë shprehimore kushtetutat dhe ligjet organike mbi gjykatat kushtetuese të vendeve si vijon: **Belgjika,**[100] **Franca,**[101]

---

[99] Ibid., fq. 316. Një standard i ngjashëm i vendimmarrjes ekziston edhe në Itali me të a.q. **sentenze additive di principio**: duke parë se **sentenze additive** po i kushtonin shumë financiarisht shoqërisë italiane, por edhe për shkak se ato po preknin shumë në dinjitetin e ligjvënësit, **GJKIt** ndërtoi këtë lloj të aktgjykimeve. Esenca e tyre është kjo: Gjykata nuk fut dispozita të reja në normën apo aktin e përgjithshëm ekzistues që është shpallur si jokushtetues dhe që, për pasojë, që do të duhej anuluar. Në vend të anulimit, Gjykata i jep udhëzime të qarta ligjvënësit lidhur me parimet që duhet t'i mishëroj në tesktin e normave specifike abstrakte me rastin e amendamentimit ose të zëvendësimit të masave parimore të cilat janë shpallur si jokushtetuese (qoftë kur bëhet fjalë për norma abstrake apo për akte të tjera juridike të natyrës normative). Kjo tutje nënkupton që Gjykata nuk fut më të a.q. **rime obbligate** (fjalitë që janë absolutisht të domosdoshme dhe të pashmangshme për shkak të përmbajtjes defektuoze në aspektin kushtetues të normës abstrakte apo të aktit tjetër juridik në formën e tyre origjinale), sepse është e pamundur për t'u identifikuar vendi i defekteve në fjalë në tekstin e normës abstrakte apo të aktit tjetër juridik. Shih për këtë arsye, ajo jep udhëzime të qarta lidhur me parimet që ligjvënësi duhet t'i ndjek gjatë amendamentimit apo zëvendësimit të normës apo aktit të së shpallur si jokushtetues. Cf. më shumë për këtë në Gustavo Zagrebelsky & Valeria Marceno, *Giustizia costituzionale* (2012), fq. 403-404.

[100] Neni 8.1 ["Kërkesat për anulim"] : "Në rastet kur kërkesa është e bazuar, Gjykata Kushtetuese do të anuloj në tërësi ose pjesërisht ligjin, dekretin apo rregullin nga neni 134 i Kushtetutës". Nenin në vijim, që flet për efektet e aktgjykimeve dhe aktvendimeve të Gjykatës Kushtetuese, në pikën e tij të specifikon se ato hyjnë në fuqi ditën e shpalljes së gazetën zyrtare të këtij vendi. *Special Act of 6 January 1989 on the Constitutional Court*. Në internet: https://www.const-court.be/en/common/home.html (shikuar më 31 korrik 2019); Për komentet, cf. më shumë në Patrick Peeters and Jens Mosselmans, "The Constitutional Court of Belgium: Safeguard of the Autonomy of the Communities and Regions". Në Nicholas Aroney and John Kincaid (eds.), *Courts in Federal Countries: Federalists or Unitarists?* (University of Toronto Press: Toronto, 2017) fq. 69-102.

[101] Neni 62.1 ["Këshilli Kushtetues"] i Kushtetutës: "Dispozita e shpallur si jokushtetuese në bazë të nenit 61 nuk mund as të shpallet dhe as të zbatohet". Paragrafi i dytë i këtij neni i jep diskrecion të plotë Këshillit Kushtetues që me vendim të vet të menaxhojë efektet e prodhuara gjatë kohës sa ka qenë në fuqi akti i shpallur jokushtetues në procedurën e kontrollit incidental, e njohur si ***Question* prioritaire de *constitutionnalité (QPC)***. Për këtë kemi folur më herët në seksionin 2.2 të kapitullit të dytë. Këtu mjafton të thuhet se në procedurat sipas **QPC** vjen deri të shfuqizimi i dispozitës kurse vetë Këshilli përcakton fatin e efekteve juridike të prodhuara gjatë kohës sa ka qenë në fuqi një dispozitë e tillë e deklaruar si jokushtetuese. Kjo tregon se as këtu nuk ka një sistem të pastër të veprimit retroaktiv të vendimeve që deklarojnë si jokushtetuese një dispozitë. France's Constitution of 1958 with Amendments through 2008. Në internet: https://www.constituteproject.org/ constitution/France 2008.pdf?lang=en (shikuar më 31 korrik 2018); Për komentet specifike të procedurës së QPC, e krijuar me reformën e vitit 2010, gjithnjë në kontekstin e efekteve përgjatë kohës të vendimeve të **KKFr**, cf. më shumë në Mathieu Disant, "Les effets dans le temps des décisions QPC". *NOUVEAUX CAHIERS DU CONSEIL CONSTITUTIONNEL* N° 40 (DOSSIER : LE CONSEIL CONSTITUTIONNEL: TROIS ANS DE QPC) - JUIN 2013. Në internet: https://www.conseil-constitutionnel.fr/node/1786/pdf (shikuar më 31 korrik 2019).

Gjermania,[102] **Italia,**[103] **Spanja**[104] etj. Në vendet e demokracive të reja kushtetuese, vendet postkomuniste si Çekia,[105] **Hungaria**[106] etj., anulimi përbën një përjashtim, sepse ai çdoherë ka efekt **ex tunc** dhe prodhon probleme në menaxhim të pasojave të tij, duke ia lëshuar vendin shfuqizimit si praktikë, ku vendimi çdoherë ka efekt **ex nunc**, vetëm për të ardhmen apo për kohën që vjen. Në këtë grup të vendeve ish-komuniste hyn edhe **Kosova**.

Kështu, me nenin 116.3 ["Efekti Juridik i Vendimeve"] të Kushtetutës përcaktohet:

"[…] Përveç nëse është përcaktuar ndryshe me vendim të Gjykatës Kushtetuese, shfuqizimi i ligjit, i aktit ose i veprimit hyn në fuqi në ditën e publikimit të vendimit të Gjykatës".

Shpallja normohet me paragrafin e fundit të nenit si më sipër,[107] cili përcakton si vijon:

"[…] Vendimet e Gjykatës Kushtetuese shpallen në Gazetën Zyrtare".

Vlen të theksohet këtu se terminologjia e nenit 116.3 në tërësi është në harmoni me formulimet e ngjashme të teksteve kushtetuese të vendeve ish-komuniste që përdorin termin shfuqizim për produktet e ligjvënësit që kanë pasur një kohë të caktuar të zbatimit. Me këtë qasje të këtij neni, Gjykatës Kushtetuese i jepet diskrecion për të menaxhuar efektet e prodhuara nga koha e zbatimit të dispozitave të ligjit të shfuqizuar me vendim. Çdoherë bëhet fjalë për **anulim** kur bëhet shpallja e tyre e pavlefshme për shkak të jokushtetutshmërisë, ku efekti është **ex tunc** (prapaveprues), kurse në rastet kur norma abstrakte ose akti tjetër juridik shpallet si jo në përputhshmëri (harmoni) me kushtetutën, atëherë gjykatat vetë vendosin për modalitetet e rivendosjes së kushtetutshmërisë së cenuar, përmes dhënies së një arsyetimi

---

[102] Neni 78 ["Kontrolli abstrakt i ligjeve"] i Ligjit për **GJKGje**: "Nëse Gjykata Kushtetuese Federale gjen se ligji federal nuk është në pajtim me LTH apo ligji i **Land**-it nuk është në pajtim me **LTH** dhe me ligjin federal, atëherë ajo anulon ligjin e tillë [...]". *Act on the Federal Constitutional Court* (Bundesverfassungsgerichtsgesetz-BVerfGG). Date of signature:12 March 1951. Në internet:http:// www.bundesverf assungsgericht.de /SharedDocs/ Downloads /EN/Gesetze/ BVerfGG.pdf?blob =publication File&v=6 (shikuar më 31 korrik 2019).

[103] Neni 30 (3) i Ligjit nr. 87/53 i **Ligjit për GJKIt**. Cituar sipas Maartije de Visser, *Constitutional Review in Europe*, fq. 317 (fusnota nr. 161); Për komente cf. më shumë në John Henry Merryman and Vincenzo Vigoriti, "*The American Journal of Comparative Law*" Vol. 150 No. 4 (1966 - 1967), fq. 665-686 (ku autori tregon nevojën për anulim të ligjeve të vjetra të kohës së Fashizmit me qëllim të spastrimit të rendit juridik nga normat dhe botëkuptimet e vjetra që shkonin kundër germës dhe shpirtit të **Italisë** republikane dhe të kushtetutës së saj të re; kjo në veçanti ka pasur të bëj me sferën e garancioneve penale kushtetuese; në fakt, autori tregon se në vendimet e para, **GJKIt** Kushtetuese kishte vendosur për anulim të ligjit me efekt prapaveprues, sepse vetë anulimi ngërthente veprimin retroaktiv të aktit të anulimit, gjë që ishte situatë e ndryshme nga shfuqizimi; deri të ky konstatim, **GJKIt** kishte ardhur përmes sqarimit se nenit 136 i **Kushtetutës së Italisë** dhe neni 30.2 i Ligjit për GJKit në thelb flisnin për të njëjtën gjë dhe se anulimi çonte domosdo në efektin retroakitv të vendimit, gjë që nënkuptonte se ligji kishte nulitet absolut që nga dita e miratimit të tij; ky pozicion ishte sqaruar në kontekstin e mosmarrëveshjeve të thella në fillim që kishin ekzistuar në mes të dy gjykatave, asaj të Kasacionit dhe Kushtetueses gjatë dekadës së parë të punës sipas kushtetutës së re italiane).

[104] Neni 39.1 ["Aktgjykimi në procedimet e jokushtetutshmërisë dhe pasojat e tij"] i Ligjit Organik nr. 2/1979 mbi Gjykatën Kushtetuese: "Kur aktgjykimi shpallë jokushtetutshmërinë e një dispozite, atëherë ajo dispozitë anulohet dhe, sipas nevojës, edhe dispozitat e tjera të ligjit të njëjtë, rregullores apo aktit tjetër që ka fuqinë e ligjit ndaj të cilave sipas asocimit apo si pasojë shtirhen pasojat e jokushtetutshmërisë së shpallur". *Organic Law 2/1979 on the Constitutional Court, of 3 October 1979, as amended by the Organic Laws 8/1984, December 26th; 4/1985, June 7th; 7/1988, June 9th; 7/1999, April 21st; 1/2000, January 1st; 6/2007, May 24th; 1/2010, February 19th; 8/2010, November 4 th; 12/2015, September 22nd and 15/2015, October 16th*. Në internet: https:// www.tribunalconstitucional. es/es/ tribunal/ normativa/ Normativa/LOTC-en.pdf (shikuar më 31 korrik 2019).

[105] Neni 71 pikat 2 & 4 ["Aktgjykimet dhe pasojat e tyre politike"] i **Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Çekisë** përcaktojnë se aktgjykimet për anulimin e normës nuk prekin vendimet që kanë filluar të zbatohen, mirëpo liritë dhe të drejtat e bazuara në ligjin e anuluar nuk mund të zbatohen. Si çdo ligj dhe dispozitë tjetër kushtetuese e vendeve demokratike, edhe ky ligj përcakton se vendimi mbi anulimin shërben si bazë për rihapjen e procedurave penale të mbyllura me vendim të formës së prerë dhe që bazohen në ligjin apo normën e anuluar.

[106] Neni 45.1 & 3 i **Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Hungarisë** *Constitutional Court Act of 16 June 1993 as amended by Acts No. 331/1993 Sb., 236/1995 Sb., 77/1998 Sb., 18/2000 Sb., 132/2000 Sb., 48/2002 Sb., 202/2002 Sb., 320/2002 Sb., 114/2003 Sb., 83/2004 Sb., 120/2004 Sb., 234/2006 Sb., 342/2006 Sb., 227/2009 Sb. 404/2012 Sb., and 275/2012 Sb.:* Në internet: https://www. usoud.cz/fileadmin/user_upload/ustavni_ soud www/ Pravni _ uprava /AJ/ Constitutional court act1821993.pdf (shikuar më 3 korrik 2019).

[107] Në disa vende, vetëm vendimet mertiore shpallen në gazetën zyrtare nacionale (Belgjika, Hungaria etj.), në të tjerat shpallen edhe vendimet jo-meritore me kusht që të jenë të arsyetuara (**Spanja**), kurse në disa asnjë lloj i vendimeve kushtetuese (**Australia, Brazili, Irlanda, Izraeli** etj.). Në rastin e fundit, vendimet publikohen vetëm në ueb faqen e gjykatës që ushtron funksionet e barasvlefshme me gjykatën kushtetuese të modelit evropian/kelsenian. Për më shumë për secilin vend si më sipër dhe për vendet e tjera që u takojnë tri modaliteteve si më sipër, cf. në përmbledhjen e punimeve të hulumtimit empirik të autorëve András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*.

të thukët, ku fjala shfuqizim zë vendin kryesor. Në këto raste, efekti është **ex nunc** (për të ardhmen). Shprehja shfuqizim, shikuar në një kuptim të ngushtë të fjalës, nuk është adekuate sepse një akt i tillë mund të ndërmerret vetëm nga ligjvënësi, që është autori origjinal i normës abstrakte apo i aktit tjetër të përgjithshëm. Ky term, megjithatë, është në pajtim me konceptin e ligjvënësit negativ, të cilin e ushtrojnë gjykatat kushtetuese **kelseniane/evriopiane.**

Në ndërkohë që terminologjia nuk dallon shumë qartë kur bëhet fjalë për vendimet që shpallin jo-kushtetuese normat abstrakte, te kontrolli kushtetues i akteve të tjera juridike të natyrës jo-abstrakte terminologjia është krejt e saktë: për aktet juridike individuale që janë jo kushtetuese çdoherë përdoret shprehja **anulim**, zakonisht me efekt **ex tunc**. Ka raste kur këto efekte menaxhohen me vendim të gjykatës kushtetuese, çështje të cilën e diskutojmë në vijim, d.m.th. çështjen e menaxhimi të efekteve juridike të hyrjes në fuqi të vendimit të gjykatës kushtetuese më të cilën norma abstrakte ose një akt juridik (i përgjithshëm ose i veçantë) shpallet si jo kushtetues. Për të menaxhuar këto gjëra që kanë të bëjnë me efektet juridike, gjykatat kushtetuese kanë prodhuar përvoja dhe modalitete të nduarnduarshme dhe të pasura të vendosjes. Këto përvoja dhe modalitetet vijnë si pasojë e faktit që gjykatat kushtetuese bashkëkohore, në të shumtën e rasteve, shpallin si jo në përputhshmëri me kushtetutën (**incompatibility declarations**) normat e sfiduara abstrakte dhe aktet tjera juridike të përgjithshme, në ndërkohë që shpallja e pavlefshme e tyre me efekt anulimin imediat (**declarations of voidness**) paraqet një praktikë gjithnjë e më të rrallë.

Në literaturën hulumtuese është vërejtur se anulimi me efekt imediat i referohet kryesisht rasteve të liberalizimit të aborteve (Gjermania, vitet 1975 dhe 1992; Spanja, viti 1985), nacionalizimit të industrisë dhe institucioneve financiare (Franca, viti 1981), reformës së qeverisjes së universiteteve (Gjermania, 1973), përpjekjeve për futjen e veprimit afirmativ (Franca, viti 1982), revidimeve të normave që kanë të bëjnë me dënimet me vdekje, privatizimeve të industrisë, krijimi i regjimeve anti-trust në sferën e shtypit dhe televizionit dhe kështu me radhë.[108]

Nuk ka vend në **Evropë** që përqafon formën e pastër të efektit **ex tunc** ose **ex nunc** të vendimeve të gjykatave të tyre kushtetuese. Lloj-lloj modifikime kanë lindur në sferën e **menaxhimit të kujdesshëm të efekteve kohore të vendimeve të gjykatave kushtetuese mbi jokushtetutshmërinë e akteve juridike** (të përgjithshme ose individuale). Vendet që nisen nga qasja klasike e anulimit me efekt **ex tunc** të akteve juridike, në të njëjtën kohë kanë autorizuar, me kushtetutë ose ligje, gjykatat e tyre kushtetuese për të vendosur që disa nga efektet e vendimit jo kushtetues mund të ngelin në efekt.[109] Në anën tjetër, gjykatat kushtetuese në disa vende mund të vendosin që, përjashtimisht, një akt juridik (abstrakt ose individual) të vazhdojë të aplikohet përkundër asaj që është jo kushtetues, krejt kjo me qëllim të mënjanimit të krijimit të situatës së vakumit juridik.[110] Brenda këtyre dy përvojave të skajshme, ekziston një praktikë e tretë, në **Francë**, ku **KKF** mund të vendos për kushtet dhe kufijtë e efekteve që prodhohen nga vendimi për anulim të normës abstrakte, duke u bazuar në secilin rast veç e veç.[111] Si një alternativë e ngjashme me këtë është ajo që i jep të drejtë gjykatës kushtetuese për të vendosur një afat të caktuar kohor brenda të cilit individët dhe subjektet tjera të së drejtës kanë mundësi për të kërkuar revokimin e vendimeve gjyqësore, të cilat, në ndërkohën e vendimmarrjes kushtetuese, kanë marrë formën **res judicata.**[112] Shumë e ngjashme me këtë është përvoja e **Italisë** dhe **Spanjës**, ku gjykatave kushtetuese iu lejohet që të autorizojnë individët për të rihapur të gjitha rastet, jo vetëm ato të natyrës penale për të cilat vlen rregulla absolute, me qëllim të rivendosjes së drejtësisë për ata që kanë pësuar nga jokushtetutshmëria e konstatuar me vendim kushtetues. U mor vesh, gjithnjë me supozim që një gjë e tillë është e mundur

---

[108] Alec Stone Sweet, " Constitutional Courts and Parliamentary Democracy" *West European Politics* Vol.25, No.1 (January 2002), fq.77–100 në fq. 93-94.

[109] Maartje de Visser, *Constitutional Review in Europe: A Comparative Analysis*, fq. 317 (fusnota nr. 163 dhe teksti që e shoqëron).

[110] Ibid., fq. 318 (fusnota nr. 164 dhe teksti që e shoqëron).

[111] Ibid., fq. 318 (fusnota nr. 165 dhe teksti që e shoqëron).

[112] Fjala është për **Belgjikën**. Ibid., fq. 318 (fusnota nr. 166 dhe teksti që e shoqëron).

sipas rregullave procedurale respektive (civile, administrative dhe rregullave të tjera procedurale).[113] Të shohim si duket kjo si më sipër në vendet që njohin **a priori** dhe në parim efektin juridik **ex nunc**, apo prospektive, të vendimeve të tyre mbi jokushtetutshmërinë dhe nëse ekziston një ngjashmëri praktike e tyre me vendet e sipërcekura të demokracive tradicionale.

Në parim, në disa prej vendeve të demokracive të reja kushtetuese, vendet ish-komuniste në të cilat gjen zbatim anulimi/shpallja e pavlefshme e normave juridike abstrakte (ose e akteve të tjera juridike) me efekt **ex nunc**, palët e afektuara me vendim të gjykatës kushtetuese kanë të drejtë që të kërkojnë rihapjen e të gjitha llojeve të procedurave që kanë marrë formën e prerë në ditën e vendimit kushtetues.[114] Në disa vende të tjera, një gjë e tillë lejohet vetëm sa i përket procedurave penale (Çekia),[115] kurse në të tjerat situata është krejtësisht e kundërt - një gjë e tillë lejohet vetëm sa u përket procedurave civile dhe administrative. Kjo nënkupton se palët që kanë fituar të drejta dhe kanë marrë përsipër detyrime në bazë të vendimeve që bazohen në norma abstrakte të shpallura si jo kushtetuese pengohen nga zbatimi në praktikë i të njëjtave (vënia e tyre në jetë).[116] Për ndryshim nga krejt këto raste, ekzistojnë vende që autorizojnë (ose e detyrojnë) gjykatën kushtetuese që në vendimin e saj të specifikojë në mënyrë shprehimore urdhrin (verdiktin) me të cilin sqarohet se anulimi i normës ka efekt retroaktiv, përkundër faktit që këto raste kanë të bëjnë me vendet e ish-komuniste.[117]

Nga tërë ky ekskursion i shkurtër, qartë shihet se, pa marrë parasysh dallimet fillestare në pikëpamje të efekteve **ex tunc** dhe **ex nunc** të vendimeve që shpallin si jo kushtetues një normë abstrakte ose ndonjë masë tjetër shtetërore, gjykatat kushtetuese nuk kanë dallime të tjera të mëdha në praktikë. Rregull i përbashkët i dy grupimeve të shteteve si më sipër është se vendimet e gjykatave kushtetuese, zakonisht janë të zbatueshme që nga koha e publikimit të tyre, përkatësisht nga dita e nesërme e publikimit të tyre në gazetën zyrtare nacionale. Kështu është edhe në **Kosovë**, siç u pa më sipër nga vetë redaktimi i nenit 116.3 & 4 të Kushtetutës. Kjo rrethanë përbën esencën e çështjes ngaqë ngre një pyetje me rëndësi kolosale praktike: a mund gjykatat kushtetuese vetë të përcaktojnë datën kur anulimi nis prodhimin e efekteve të veta juridike, në një kohë që norma abstrakte jo kushtetuese (apo akti tjetër juridik) humb fuqinë e vet detyruese? Rëndësia e kësaj pyetje është vërejtur edhe në praktikën e **Gjykatës së Strasburgut,** e cila qysh në vitin 2010 ka bërë fjalë, në një vendim të saj, për rëndësinë e dallimit në mes të humbjes së fuqisë detyruese të normës së shpallur si jo kushtetuese dhe zbatimit të saj përgjatë një kohe kalimtare, përkundër të qenit të saj jo kushtetuese. Ka rëndësi që kjo situatë të lejohet dhe të përligjet sepse, gjithnjë sipas **Gjykatës së Strasburgut**, fort duhet pasur parasysh respektimin e parimit të sigurisë juridike dhe të parashikueshmërisë në shfrytëzimin e lirive dhe të drejtave të garantuara me **KEDNJ.**[118]

Hapja e mundësisë si më sipër për shtyrjen e efekteve të vendimit mbi anulimin e aktit jo kushtetues dhe caktimit të datës kur akti juridik i anuluar humb efektin e vet, ka një rëndësi të madhe praktike për zbutjen e ndikimit të vendimeve mbi jo kushtetutshmërinë në institucionet politike dhe në rendin juridik marr tërësi. Një gjë e tillë vjen në shprehje posaçërisht në **sferën sociale** dhe të **taksave** ku, me vendime të tilla anuluese me të cilat konstatohet jo kushtetutshmëria, mund të cenohet parimi i barazisë, nisur nga fakti se njerëzit kanë fituar të drejta dhe kanë marrë detyrime mbi bazën e akteve juridike të anuluara (të përgjithshme apo individuale). Këto dy fusha kërkojnë një analizë të hollë lidhur me shpërndarjen e buxhetit shtetëror në mënyrë të barabartë dhe, për pasojë, një vendimmarrje që merr parasysh këto analiza.

---

113 Ibid., fq. 318 (fusnota nr. 167 dhe teksti që e shoqëron).

114 Ibid., fq. 318 (fusnota nr.168 dhe teksti që e shoqëron; këtu autori flet vetëm për **Poloninë**, mirëpo edhe vendet tjera parashikojnë procedura të ngjashme; edhe sikur mos të parashikonin një gjë të tillë, parimi i sundimit të ligjit dhe i garancionit kushtetues të efektivitetit në shfrytëzimin e lirive dhe të drejtave kushtetuese bëjnë që një gjë e tillë të nënkuptohet; ndryshe nuk ka asnjë kuptim anulimi i normave abstrakte si pasojë e jokushtetutshmërisë së tyre nëse ai anulim nuk është në funksion të realizimit të plotë të lirive dhe të drejtave kushtetuese).

115 Ibid., fq. 169.

116 Kështu është rasti, ta zëmë, me Çekinë. Ibid., fq. 318 (fusnota nr. 170 dhe teksti që e shoqëron).

117 Kështu është rasti, ta zëmë, me **Hungarinë** (fusnota nr. 171 dhe teksti që e shoqëron).

118 Ibid. fq. 319 (fusnota nr. 172 dhe teksti që e shoqëron).

E njëjta vlen edhe për sferën e **privatizimit** dhe të **restituimit të pronave**.[119] Në të vërtetë në këto dy sfera vlen më shumë se çdo kund tjetër. Kjo është kështu së paku gjykuar sipas përvojave të vendeve ish-komuniste: në këto dy sfera, anulimi i akteve juridike (ligjeve në rend të parë) me efekt të menjëhershëm ka për pasojë përkeqësimin e situatës jo kushtetuese ekzistuese dhe krijimin e një kaosi të tërësishëm shoqëror dhe të një gjendje akoma më jo kushtetuese se që ka qenë para anulimit. Pikërisht për këto arsye, ka shumë rëndësi që gjykatat të kenë një hapësirë të autorizuar për t'i akorduar ligjvënësit një kohë të caktuar për adresimin e situatës së konstatuar jo kushtetuese si pasojë e ligjvënies apo e masave të tjera shtetërore të ndërmarra nga ana e organeve kushtetuese. Kjo hapësirë shfaqet në të drejtën e tyre për të shtyrë kohën e veprimit të efekteve juridike të vendimit për anulim përmes shtyrjes së tyre me të njëjtin vendim, ashtu që koha e humbjes së efektivitetit të këtyre akteve të gjetura si jo kushtetuese nuk përputhet me momentin kur ato janë shpallur si të tilla dhe janë anuluar.[120]
Mandati që u akordohet gjykatave kushtetuese për të shtyrë kohën e humbjes së fuqisë juridike të normës (apo të aktit tjetër shtetëror) të gjetur si jo kushtetuese, mund të jetë i përcaktuar me kushtetutë apo me ligj organik që normon organizimin dhe funksionimin e gjykatës kushtetuese. Ai mandat mund të ndërtohet edhe si pasojë e praktikës kreative aktiviste të gjykatave kushtetuese. Nëse shikohet me kujdes historia e gjyqësisë kushtetuese në **Evropë** në këtë aspekt, atëherë lehtë mund të vërehet që mandati nga varianti i parë, ai krijuar përmes autorizimit kushtetues dhe ligjor, i takon praktikës së vendeve ish-komuniste,[121] kurse situata e dytë, ajo e hapësirës së krijuar si rezultat i aktivizmit gjyqësor dhe kreativitetit të gjykatave kushtetuese, më tepër i takon vendeve të demokracive kushtetuese tradicionale.[122]

15. 2. 2. 3. Gjetja e shkeljes së normave dhe parimeve kushtetuese, pa pasur për pasojë anulimin e normës së sfiduar (apo ligjit si tërësi)

Nga shqyrtimi i deritanishëm mund të vërehet se kuadri juridiko-kushtetues që komandon ushtrimin e juridiksionit kushtetues mban një lidhje krejt të natyrshme në mes të anulimit të normës abstrakte dhe jo kushtetutshmërisë së deklaruar me vendim të gjykatës kushtetuese. Kjo, sikundër mund të imagjinohet, përbën themelin dhe vijën e fundit të asaj që njihet si **ligjvënie negative**. Në të vërtetë, themelimi i gjyqësisë kushtetuese kelseniane ka gjenezën e vet në këtë cilësi dukshëm dihotomike të vendimmarrjes, përkatësisht në dihotominë **normë jo kushtetuese** vs. **anulim**.

Përvojat e gjyqësisë kelseniane në ndërkohë kanë avancuar aq shumë sa që sot jo rrallë gjejmë praktika të gjykatave kushtetuese që e shkëpusin këtë lidhje në mes të **shkakut** (norma jo kushtetuese) dhe **pasojës** (anulimi i normës jo kushtetuese). Nga përvojat e shumta të shkëputjes së tillë të lidhjes shkakore, lidhje që

---

[119] Për një analizë të shkëlqyer të vendimmarrjeve nacionale si dhe të vendimeve të **Gjykatës së Strasburgut** lidhur me **pr vatizimet** dhe **restituimet e pronave** dhe të drejtave të tjera në vendet **ish-komuniste**, vështirësitë në gjetjen dhe sigurimin e balansit, në njërën anë, në mes të barazisë dhe drejtësisë dhe, në anën tjetër, sigurimit të sundimit të ligjit sipas standardeve nga jurisprudence në **Strasburg**, shih më shumë në veprën e Csongor Kuti, *Post-communist Restitution and the Rule of Law* (Central European University: Budapest & New York, 2009) (shoqëritë e **Evropës jug-lindore** kanë kaluar nëpër një zhveshje përmasash marramendëse nga të drejtat e tyre pronësore prej regjimeve autoritare, që kanë nisur pas **Luftës së Dytë Botërore** dhe kanë përfunduar me lëvizjen e kolkozeve në fillim të viteve '60 të shekullit të kaluar. **Csongor Kuti** shtjellon zhdëmtimet e shpronësimeve të kryera nga komunistët, të cilat u ndërmmorën pas vitit 1989. Ky shtjellim ka perspektivë të shumanëshme, siç janë perspektiva e gjyqësisë kushtetuese, sundimit të ligjit, por edhe nga përspektiva e politikave identitare. Në thelb të krejt shtjellimit është që në vendet e tranzicionit post-komunist është shumë e vështirë të respektojnë postulalet e sundimit të ligjit nisur nga fakti se drejtësia shoqërore është qëllim që synohet të arrihet me çdo kusht, ashtu që mjeti dhe qëllimi janë e njëjta gjë).

[120] Maartje de Visser, *Constitutional Review in Europe: A Comparative Analysis*, fq. 319.

[121] Ibid., fq.319 (fusnota nr. 173 dhe teksti që e shoqëron). Në këtë vend, autori jep rastet e tri vendeve ish-komuniste: Çekisë, Hungarisë dhe **Polonisë**. Në ndërkohë që në rastin cek dhe polak, kushtetuta edhe ligjet për gjykatat e tyre kushtetuese autorizojnë një shmangie të tillë, në rastin hungarez ky autorizim për shmangie jepet vetëm me ligjin që rregullon organizimin dhe funksionimin e **GJKHu**, Ligji CLI i vitit 2011. Sipas këtij Ligji, Gjykata autorizohet që të shmanget nga rregulla normale mbi shfuqizimin dhe moszbatimin e ligjit të deklaruar si jokushtetues, me kusht që kjo të jetë në interes të mbrojtjes së Kushtetutës, të interesave të sigurisë juridike apo me qëllim të mbrojtjes së ndonjë interesi tjetër të palës që ka nisur procedurën për kontroll abstrakt kushtetues.

[122] Ibid., fq. 320 (fusnota nr. 177 dhe teksti që e shoqëron). Në këtë vend, autori jep rastet e **Belgjikës**, **Francës. Gjermanisë, Italisë dhe Spanjës**, si dhe një literaturë të pasur që shtjellon praktikën e këtyre vendeve kur shtyejnë anulimin e ligjeve me qëllim që t'u jepet kohë e mjaftueshme organeve shtetërore dhe individëve për të realizuar detyrimet e tyre kushtetuese.

shërben si definuese e gjyqësisë klasike kushtetuese negative, në vijim kemi përzgjedhur praktikat e gjyqësisë kushtetuese në tri vendet më reprezentative. E kemi fjalë për **Gjermaninë**, **Italinë** dhe **Spanjën**.[123] Kjo renditje diktohet nga vjetërsia e lindjes së praktikës me shkëputjen e lidhjes shkakore si më sipër, si dhe nga ndikimi kolosal që ka pasur **GJKGje** në Itali dhe Spanjë dhe në vendet e ndryshme në dy anët e Atlantikut që kultivojnë përvojat që i diskutojmë në këtë seksion.[124]

Në **Gjermani**, për herë të parë në vitin 1970, ka nisur zbatimi i përvojës së shkëputjes së jo kushtetutshmërisë së normës abstrakte juridike apo aktit të përgjithshëm nga shpallja e e tyre e pavlefshme me pasojë anulimin.[125] Më pastaj, mundësia e shpalljes së normës juridike jo në pajtim më **LTH** u sanksionua me amendamentimet e viteve '70 të shekullit të kaluar në **Ligjin për GJKGje**. Me këtë rast u krijua mundësia e ndërtimit të standardit sipas të cilit norma juridike mund të shpallej e pavlefshme për shkak se nuk ishte në pajtim me **LTH** ose, e kundërta, se ajo ishte në pajtim me kushtetutën dhe, për pasojë, ngelej në fuqi dhe vazhdonte jetën e saj të qetë duke u zbatuar ashtu siç kishte thënë ligjvënësi gjerman. Një gjë e tillë konstatohet nga redaktimi i dispozitës së nenin 31 (2) të **Ligjit për GJKGje,** miratuar me reformat e viteve '70 të shekullit të kaluar. Kjo dispozitë thotë se Gjykata mund të shpallë "[...] një ligj të jetë në pajtim ose në mospajtim me Ligjin Themelor ose që ligji është i pavfleshëm, nul dhe pafuqi juridike)".[126] Por në këtë nen nuk rregullohen pasojat e shpalljes së normës si jo në pajtim me **LTH** e as situatat në të cilat kjo do të mund të ndodhte. Këto situata, gjykuar sipas vendit të këtyre dispozitave, kanë të bëjnë me procedurat e ankesës kushtetuese: në nenin si më sipër, GJKGje autorizohet për llojin e vendimit që mund ta merr në fund të procesit me qëllim të menaxhimit të pasojave të shpalljes në mospajtim më **LTH** të normës juridike. Kjo nuk nënkupton se duhet të anulohet ligji me doemos, me efekt heqjen e tij nga sistemi juridik gjerman: **nuliteti dhe heqja e fuqisë juridike** normës së një ligji e shpallur si jo në pajtim me **LTH** paraqesin një fazë apo hap që mund të merret edhe më vonë.[127]

Cilat, pra, janë hapat juridikë që **GJKGje** autorizohet t'i bëjë në vijim të menaxhimit të pasojave juridike të vendimit mbi shpalljen jo në pajtim me **LTH** të normës abstrakte, pas hyrjes në fuqi të vendimit të saj që ngërthen verdiktin për një shpallje të tillë?

Pasojat juridike të vendimit për shpalljen jo në pajtim më **LTH** të një normë juridike janë të dyllojta. Në rend të parë, ligjvënësi gjerman urdhërohet që të korrigjoj situatën jo kushtetuese të cilën ai vetë e ka krijuar. Kjo pasojë konsiderohet si më e rëndësishmja në rastet e vendimit që deklaron një normë në mospajtim me **LTH** dhe që dallon nga situata e vendimit kur një normë abstrakte shpallet e pavlefshme (nul dhe pa asnjë fuqi juridike). Në rastin e vendimeve që deklarojnë si nul dhe pa asnjë fuqi juridike (i shpallin të pavlefshme) normat abstrakte juridike, ligjvënësi nuk ka nevojë të ndërmerr masat e ndreqjes së situatës së konstatuar si jo kushtetuese sepse ligji nuk ekziston më. Kurse në rastin e vendimit mbi deklarimin si jo në pajtim me **LTH**, **GJKGje** skicon në formë urdhri edhe modalitetet që duhet t'i ketë parasysh ligjvënësi gjerman gjatë ndreqjes

---

123 Ibid., fq 320-324.

124 Për këtë përvojë nëpër vende të tjera, përveç këtyre që diskutohen në këtë seksion, Cf. më shumë në hulumtimin rreth një mijë faqesh të edituar nga Allan R. Brewer – Carias (ed.), *Constitutional Courts as Positive Legislators. A Comparative Law Study* (Cambridge University Press: Cambridge, 2011) (ku autorët e vendeve kryesore evropiane, disa vendeve të **Amerikës Latine** dhe **Australisë** kanë dhënënraportimet e tyre hulumtuese lidhur me rolin e gjykatave kushtetuese si ligjvënës pozitiv; ata dëshmojnë se gjykatat kushtetuese kanë ndërtuar një praktikë mjaft të shpeshtë që, në vend se të anulojnë apo shpallin të pavlefshëm një ligj apo normat e tij, ata bëjnë interpretimet e tyre në harmoni me kushtetutën në nderim të **parimit të prezumimit të kushtetutshmërisë së ligjeve**).

125 Maartje de Visser, *Constitutional Review in Europe: A Comparative Analysis*, fq. 323.

126 Ibid., fq. 323 (fusnota nr. 192 dhe teksti që e shoqëron).

127 Kjo zgjidhje ligjore e nenit 31 (2) e **Ligjit për GJKGje** ka të bëjë me procedurat e ankesës kushtetuese dhe mundësitë e Gjykatës për të menaxhuar pasojat juridike të vendimeve të veta kur ato gjejnë jokushtetutshmëri: nëse shpallja e ligjit si jokushtetues do të pasohet me anulimin imediat të tij, kjo gjë varet nga Gjykata. Po ashtu, sipas këtij neni, Gjykata mund të deklaroj një ligj si nul dhe pa fuqi juridike për shkak të faktit se ai ishte në kundërshtim me **LTH**. Në **Ligjin për GJKGje**, megjithatë, ekziston një nen tjetër, neni 78 (i futur në pjesën e kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë), i cili thotë se në rastet kur ligji më nuk është në pajtim me **LTH**, atëherë Gjykata duhet të shpall ligjin nul dhe pa fuqi juridike (të pvafleshëm në tërësi). Praktika gjermane, jashtë çdo diskutimi, bën pjesë në praktikat e vendeve që kanë arritur të bëjnë ndarjen (shkëputjen) e jokushtetutshmërisë së normës abstrakte nga anulimi i saj dhe, për pasojë, largimin e normës së tillë (ose aktit të përgjithshëm në të cilin ka qenë norma jokushtetuese) jashtë rendit juridik nacional.

së gjendjes jo kushtetuese, sikundër dhe mënjanimin e pasojave të shkaktuara nga zbatimi i normës me defekte kushtetuese të konstatuara. Për këtë qëllim dhe për këtë arsye, ajo zakonisht e cakton një afat të caktuar brenda të cilit ligjvënësi duhet të bëjë këtë ndreqje të gjendjes jo kushtetuese, nën kërcënim të hapur për kompensim të atyre që mund të jenë dëmtuar për shkak të inercionit të ligjvënësit gjerman.

Në vijim, si më sipër, pasoja e dytë konsiston në faktin që gjykatat e rregullta më nuk mund të bëjnë zbatimin e normës apo aktit të përgjithshëm të gjetur me vendim si jo në pajtim me **LTH** në procedurat gjyqësore në rrjedhim, ani se norma apo ligji akoma ngelin në librat e ligjeve. Kjo nuk do të thotë se një normë apo ligj i tillë nuk mund të zbatohen: kjo mund të bëhet vetëm më vendim shprehimor të GJKGje me të cilin konstatohet jo pajtueshmëria me **LTH** të normës apo ligjit përkatës. Në praktikë, kjo situatë zakonisht ka të bëj me lëmin e taksave dhe përfshinë zbatimin për kohën e mbetur të zbatimit dhe vlerësimit të taksave dhe tatimeve, kohë që thuajse është në mbarim e sipër, por mund të shtrihet edhe ndaj rasteve penale.[128]

Ekzistojnë edhe tri kategori të rasteve të tjera, veç atyre të sipërcekura, kur **GJKGje** kufizohet vetëm në shpalljen e ligjit apo normës abstrakte si jo në pajtim (përputhje) me **LTH**, pa i shpallur ato pavlefshme (nul dhe të pa fuqi juridike, me pasojë anulimin e menjëhershëm). Në **kategorinë e parë** janë rastet kur norma abstrakte ose ligji i kontestuar cenojnë **parimin kushtetues të barazisë**. Për të adresuar këtë ekzistojnë disa mundësi për ligjvënësin: grupimi origjinal i përfituesve nga ligji ose norma e caktuar abstrake juridike me defekt kushtetues që cenon barazinë kushtetuese mund të zgjerohet ose të definohet në një mënyrë tjetër që nuk bie ndesh me parimin e barazisë. Kjo nënkupton se, sipas logjikës së vendimmarrjes së **GJKGje,** ligjvënësi ka të drejtë të mënjanojë këtë parregullsi kushtetuese. Me këtë, ajo nuk ndërhyn në diskrecionin e ligjvënësit për të bërë zgjidhje politike me rastin e mënjanimit të parregullsisë së gjetur kushtetuese, me qëllim që gjendja të rikthehet në parametrat kushtetues të **LTH**. Kjo nënkupton se, në praktikë, ligji apo norma abstrakte do të anulohet atëherë kur ekziston vetëm një zgjidhje (rrugë) për të ndrequr jo kushtetutshmërinë që ka të bëj me cenimin e parimit të barazisë dhe është e qartë se atë zgjidhje do ta bënte edhe ligjvënësi gjerman. Veç këtij rasti, anulimi do të ndodh edhe atëherë kur kuadri ligjor i sfiduar që ankorohet në ligjin apo normën përkatëse abstrakte, për të mënjanuar cenimin e parimit të barazisë kushtetuese nuk lë rrugë tjetër pos anulimit.[129]

Në vijim si më sipër, **kategoria e dytë** kur **GJKGje** përmbahet nga anulimi i ligjit, duke u kufizuar në mënyrë ekskluzive vetëm në shpalljen e normës apo ligjit të sfiduar si të papajtueshëm me **LTH**, përfshinë rastet kur anulimi do të përkeqësonte edhe më shumë situatën duke e bërë atë akoma më pak kushtetuese se **status quo**-ja ekzistuese.

E fundit, **kategoria e tretë**, ka të bëjë me rastet që lidhen me nenin 117 (1) të **LTH** dhe ka të bëjë me ligjet dhe normat juridike abstrakte të miratuara para hyrjes së tij në fuqi. Po ashtu, ekzistojnë edhe disa situata që kanë pasur të bëjnë me disa ligje kalimtare që janë nxjerr pas **Luftës së Dytë Botërore** me qëllim të implementimit të **LTH**.[130] Në literaturë është vërejtur se kjo kategori i takon të kaluarës kushtetuese gjermane dhe nuk ka ndonjë vlerë të madhe[131].

---

128 Maartje de Visser, *Constitutional Review in Europe: A Comparative Analysis*, fq. 323 (fusnota nr. 196 dhe teksti që e shoqëron; aty tregohet se **GJKGje** ka vënë në dukje se i jep më shumë përparësi interesit publik për një politikë stabile fiskale dhe buxhetore, planifikim të buxhetit dhe financave, si dhe për ushtrimin uniform të administratës; po ashtu, në praktikë, ajo e ka zbatuar këtë në lëminë penale kur ka pasur të bëjë me paraburgimin; kështu, në një rast ka konstatuar se anulimi me efekt imediat i një dispozite juridike mbi paraburgimin do të mund të shkaktonte kaos të vërtetë ngaqë do të kishte efektin e lirimit të menjëhershëm të krejt të atyre që gjendeshin në paraburgim, gjë që do të paraqiste probleme të rënda për gjyqësorin, administrimin e drejtësisë dhe për policinë).

129 Ibid., fq. 324 (fusnota nr. 198 dhe teksti që e shoqëron).

130 Neni 117.1. ["Pezullimi i hyrjes në fuqi të dy të drejtave themelore"] i **LTH**: "(1) Ligji që është në shpërputhje me dispozitën e paragrafit 2 të nenit 3 të këtij Ligji Themelor ngelet në fuqi deri të kthehet në përputhje me atë dispozitë, por jo përtej datës 31 mars 1953ain in force until adapted to that provision, but not beyond 31 March 1953". (Paragrafi i dytë i nenit të tretë të **LTH** normon barazinë gjinore që ka ekzistuar në kohën e nxjerrjes së **LTH** dhe e ka vënë si detyrë kushtetuese shprehimore për Shtetin që të eliminojë këtë pabarazi me qëllim të sigurimit të barazisë së plotë para ligjit).

131 Për komentet dhe dy vendimet e para të **GJKGje** që implementojnë barazinë gjinore në kuptim të paragrafit të dytë të nenit 3 si më sipër, Cf. Maartje de Visser, *Constitutional Review in Europe: A Comparative Analysis*, fq. 324 (fusnota nr. 200 dhe komentet e autorit aty, ku i citon vendimet e Gjykatës që kanë të bëjnë me këtë kategori të ligjeve).

GJKIt ka një praktikë mjaft të pasur lidhur me shkëputjen (ndarjen) e anulimit të një norme abstrake ose ligji nga shpallja si jo në pajtim me kushtetutën apo si jokushtetuese. Në këtë kuptim, praktika italiane ka krijuar dy modalitete të kësaj shkëputje (ndarje): i pari konsiston në atë që, kur ajo gjen se një normë abstrakte ose një akt i përgjithshëm juridik nuk është në pajtim me Kushtetutën, atëherë ajo thjeshtë shtyen publikimin e vendimit për një kohë të caktuar. Kjo nënkupton se këtu nuk ka mundësi që të vij deri te zbatimi i përkohshëm kalimtar i normës apo aktit të përgjithshëm juridik, i cili është gjetur si jo në pajtim me parametrat kushtetues; i dyti konsiston në atë që italianët e cilësojnë si **jokushtetutshmëri e verifikuar por jo e shpallur** (**incostituzionalità accertata ma non dichiarata**) e normës juridike apo aktit tjetër të përgjithshëm. Me këtë nënkuptohet situata kur vërtetohet se norma apo akti i përgjithshëm kanë defekte serioze kushtetuese, por nuk shpallet se janë të tilla për shkak se ai veprim do të duhej të pasohej me anulim të tyre. Shtyerja e anulimit të ligjit bëhet me një vërejtje për ligjvënësin me të cilën ai urdhërohet që për një kohë të caktuar të ndreq defektet e konstatuara kushtetuese në produktin e tij, përkatësisht të mënjanoj jokushtetutshmërinë e vërtetuar me vendim të **GJKIt.** Nëse as kjo nuk ndodh, atëherë ajo në gjykimin e dytë e shpall të pavlefshëm normën apo ligjin, të gjetur si jo kushtetues dhe, për pasojë, i anulon (i shpall nul dhe pa asnjë fuqi juridike). Kjo në doktrinën italiane quhet **doppia pronuncia**, kurse vetë aktgjykimet e kanë cilësinë e **aktgjykimeve kërcënuese** me të cilat ligjvënësi paralajmërohet për pasojat juridike të anulimit (**sentenze monito**).[132]

Kohëve të fundit, **GJKIt** nuk ka shprehur shumë vullnet për të sanksionuar ligjvënësin me anulim të produkteve të tij dhe ka zgjedhur një lloj tjetër të vendimmarrjes. E kemi fjalën për vendimet e njohura si **sentenze adittive di principio**. Te ky lloj i vendimeve, ajo nuk shton fjalë të reja, të a.q. **rime obligatte**, por jep udhëzime të qarta për ligjvënësin dhe gjyqësorin e rregullt për atë se si duhet të duket në të ardhmen përmbajtja parimore e normës abstrakte apo e aktit tjetër juridik me fuqi normative. Ky lloj aktgjykimi, ligjvënësit i jep udhëzime të qarta lidhur me parimet që duhet të reflektohen me rastin e amendamentimit apo zëvendësimit të produktit legjislativ që është gjetur në shpërputhje me Kushtetutën, kurse gjyqësorit të rregullt, udhëzimet i hyjnë në punë sa i përket mënyrës që ai duhet të ndjek gjatë interpretimit në të ardhmen të normës apo aktit tjetër të përgjithshëm.[133] Ajo që ka qenë kontestuese me këtë lloj të vendimeve dhe që është vërejtur në literaturë juridike, kryesisht i referohet faktit se norma apo akti juridik ngelet në librat juridik dhe zbatohet ndaj palëve duke vazhduar të prodhojë pasoja juridike të dëmshme dhe jokushtetuese për palët dhe sistemin juridik si tërësi. Ky shqetësim akoma nuk ka gjetur adresim adekuat në gjyqësinë kushtetuese italiane.[134]

Spanja ka nisur relativisht vonë praktikën e ndarjes (shkëputjes) së shpalljes së një norme apo akti juridik të përgjithshëm jokushtetues, në njërën anë, nga deklarimi i tyre nul dhe pa fuqi juridike (shpallja e pavlefshme), me pasojë anulimin e tyre, nga ana tjetër. Një vendim i vitit 1989, i cili kishte të bënte me një çift të martuar dhe tatimin e përbashkët që ata kishin paguar, nisi praktikën si më sipër të ndarjes së këtyre dy koncepteve. Vendimi tha se, sikur mos të kishin qenë të martuar, por të kishin bashkëjetuar si një çift në bashkësi jashtëmartesore, taksat e kërkuesve do të kishin qenë shumë më të ulëta.[135]Si palë të pakënaqura, kërkuesit (bashkëshortët) paraqitën

---

132 Roberto Romboli, Carmela Salazar, Tania Groppi, Andrea Pertici, Roberto Pinardi and Gianpaolo Parodi, "Il processo costituzionale: la tipologia delle decisioni", fq. 144 & 152-160.

133 Cf. fusnotat nr. 97-98, **supra**, si dhe teksti që i shoqëron. Cf. Po ashtu edhe Roberto Romboli, Carmela Salazar, Tania Groppi, Andrea Pertici, Roberto Pinardi and Gianpaolo Parodi, "Il processo costituzionale: la tipologia delle decisioni", fq. 160-164.

134 Maartje de Visser, *Constitutional Review in Europe: A Comparative Analysis*, fq. 322.

135 Javier Garcia Roca, "Effects, Enforceability and the Exceution of the Decisions of the Spanish Constitutional Court", a report by presented at the Seminar on the Execution of Decisions of the Constitutional Court Kyiv, Ukraine, 28-29 October 1999, organised by the European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), Strasbourg, 8 December 1999 Restricted CDL-JU (99) 28 Engl. Only., në seksionin 1.1 e tutje (fq. 2 bis). Në internet: https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-JU(1999)028-e; Blanca Rodrigues Ruis, "Recognizing the rights of unmarried cohabitants in Spain: Why not treat them like married couples? *International Journal of Constitutional Law* Vol. 2 No. 4 (2004) fq. 669-690 në fq. 676-678.

një ankesë kushtetuese (**amparo**) në **TKSp**, i cili gjeti se pagesa e tatimit të përbashkët paraqet dëmtim pa të drejtë të tyre, në kundërshtim me parimin kushtetuese të barazisë dhe duke cenuar detyrimin kushtetues të autoriteteve publike për mbrojtje shoqërore, ekonomike dhe juridike të familjes spanjolle.[136] Në arsyetimin e vet për këtë rast, ai konstatoi se tatimi i përbashkët vetpërveti nuk është jo kushtetues, por vetëm aspektet specifike të përllogaritjes së tij me qëllim të përcaktimit të përgjegjësisë fiskale dhe tatimore të bashkëshortëve. Kjo mënyrë e përllogaritjes, sipas saj, e bënte ligjin e kontestuar jo kushtetues ekskluzivisht sa i përket situatës së bashkëshortëve të martuar. Ai, megjithatë, vendosi që mos ta anulonte ligjin e sfiduar dhe atë për disa arsye, të cilat jepen në vijim.

E para, ligji i sfiduar që cenonte barazinë dhe nuk ofronte garancionet e sipërcekura shoqërore, ekonomike dhe juridike për familjen për shkak se nuk paraqitej nevoja për një gjë të tillë, nisur nga fakti se anulimi do ta eliminonte ligjin në fjalë nga rendi juridik për të gjitha situatat e tjera të caktimit të tatimeve dhe të përgjegjësisë fiskale të natyrës së përbashkët; as zgjerimi nga ana e tij i fushës së zbatimit të këtij ligji në bashkësitë jashtëmartesore nuk do të përbënte përgjigje adekuate që mënjanon (ndreq) gjendjen jo kushtetuese të konstatuar nga ai.

E dyta, sipas **LTKS,** Gjykata nuk ka të drejtë të shtyjë apo menaxhojë aspektet kohore të efekteve juridike të vendimit mbi anulimin e një produkti të ligjvënësit: çdoherë kur konstatohet jo kushtetutshmëria e një produkti të ligjvënësit, masa e tillë pasohet me largimin nga rendi juridik, me fuqi **erga omnes**, të produktit të tillë të ligjvënësit. Kjo ndodh që nga momenti i publikimit të vendimit në **Gazetën Zyrtare të Spanjës**.

E treta dhe e fundit ka të bëjë me dy arsyet si më sipër: meqë **LTKS** nuk autorizon ndarjen e deklaratës mbi jo kushtetutshmërinë nga anulimi i përnjëhershëm i produktit të ligjvënësit, përkatësisht nuk autorizon ndarjen e konstatimit të jo kushtetutshmërisë së produktit të parlamentit nga shpallja e tij i pavlefshëm, nul dhe pa fuqi juridike, si dhe nisur nga fakti që nuk ka mundësi zgjatimi të zbatimit të ligjit të tillë diskriminues në bashkësitë jashtëmartesore, atëherë **TKSp** ka përvetësuar për vete të drejtën për të menaxhuar efektet juridike të deklaratës mbi jo kushtetutshmërinë e produktit të ligjvënësit (për arsyet e sipërcekura). Në krye të kësaj qëndron edhe një fakt i fundit, sipas arsyetimit të **TKSp**: përmbajtja e vendimit për jo kushtetutshmëri nuk mund të jetë e njëjtë për çdo situatë të përllogaritjes së tatimeve të përbashkëta dhe konstatimit të përgjegjësisë fiskale të shtetasve spanjoll, gjë që shtron nevojën e mosanulimit të ligjit. Një gjë e tillë do të kishte fuqi të përgjithshme detyruese, **erga omnes**, dhe do të përfshinte çdo tatim të përbashkët që ka për qëllim konstatimin e përgjegjësisë së përbashkët fiskale. Kjo do të nënkuptonte që konstatimi i përgjegjësisë fiskale dhe i tatimit të përbashkët përbëjnë një masë legjitime në aspektin kushtetues, por që përllogaritja e tatimit, si në lartësi ashtu dhe në përmbajtje, duhet të bëhet për çdo rast veç e veç.

15. 3. Struktura dhe llojet e argumentit kushtetues

Në jurisprudencën krahasimore, gjykatat kushtetuese përdorin argumente të ndryshme kushtetuese, të cilat kanë një strukturë të caktuar argumentative me të cilat arsyetohet vendimmarrja kushtetuese. Struktura e argumenteve të përdorura në arsyetimin e vendimit dhe vetë arsyetimi i tyre formojnë llojin e argumentit kushtetues. Këtë problematikë e trajtojmë në vijim të këtij seksioni. Nuk ka asnjë rëndësi se për cilin model të gjyqësisë kushtetuese bëhet fjalë. Kjo është kështu sepse fokusi i analizës sonë nuk është organizimi i brendshëm dhe struktura e gjykatave kushtetuese (ose gjykatave të tjera të barasvlefshme me to), përbërja e tyre dhe vëllimi i punës në to, ndikimi i faktorëve institucionalë, i kulturës dhe i faktorëve të tjerë në vendimmarrje dhe kështu me radhë. Fokusi i analizës sonë këtu është te argumentet e përdorura dhe përmbajtja e arsyetimit të dhënë për vendimmarrje.

Lidhur me strukturën e argumenteve kushtetuese, pyetja që shtrohet është si vijon: cila është struktura e zakonshme (standarde) e argumenteve të dhëna në një vendim? Në këtë kuptim, në hulum-

[136] Ibid., fq. 676-678.

timet krahasimore janë vërejtur tri lloje të strukturave të argumentit kushtetues, të cilat përdoren në vendimmarrjet në gjyqësinë kushtetuese.[137] Ato janë:

- struktura e argumenteve kushtetuese me një rresht që ka natyrë përfundimtare (që e mbyllë argumentin e parashtruar me qëllim të vërtetimit të fakteve kushtetuese), i njohur ndryshe si "**rrathët lidhës zinxhiror**"; kjo strukturë cilësohet nga një seri premisash dhe përfundimesh të ndërvarura që formojnë një argument të qëndrueshëm në vetvete në mënyrë të pavarur;
- struktura e argumenteve kushtetuese me shumë argumente paralele (që përdorë strukturë argumentuese kumulative, brenda së cilës pikëpamjet e ndryshme kanë fuqi autonome por që shpijnë në të njëjtin përfundim), e njohur ndryshe si "**argumenti këmbët e karriges**"; këtu ekzistojnë disa konsiderata të vetëmjaftueshme që pak a shumë shpijnë deri te përfundimi i njëjtë; dhe
- struktura e argumenteve kushtetuese me argumente të përdorura paralelisht, të cilat, megjithatë, individualisht nuk i provojnë në mënyrë përfundimtare faktet kushtetuese, përveç nëse merren në shqyrtim të gjitha së bashku; ky njihet ndryshe si "**argumenti me strukturë dialoguese"**; në këtë strukturë parashtrohen dhe mbarështohen konsiderata të ndryshme, të cilat në vendim prezantohen si diçka që nuk janë as të domosdoshme dhe as të nevojshme për të nxjerrë një konkluzion përfundimtar, por vetëm si elemente treguese me rëndësi për zgjidhjen e rastit apo mosmarrëveshjes kushtetuese.

Kjo renditje e këtyre tri llojeve të strukturës së argumentit kushtetues është bërë në bazë të qartësisë së tyre kundrejt njëri tjetrit: **struktura e argumenteve kushtetuese me një rresht** që ka natyrë përfundimtare (që e mbyllë argumentin e parashtruar me qëllim të vërtetimit të fakteve kushtetuese), i njohur ndryshe si "**rrathët lidhës zinxhiror**", është struktura më e qartë ndër të tria, kurse më e paqarta dhe më e çoroditura është **struktura e argumenteve kushtetuese me argumente të përdorura paralelisht**, të cilat, megjithatë, individualisht nuk i provojnë në mënyrë përfundimtare faktet kushtetuese, përveç nëse merren në shqyrtim së bashku. Kjo strukturë, siç u tha më sipër, ndryshe njihet si "**argumenti me strukturë dialoguese".** Në modelin kelsenian të gjyqësisë kushtetuese, megjithatë, në të shumtën e rasteve dominon **struktura e argumentit "këmbët e karriges**".

Të shohim si duket kjo sipas përvojës konkrete të vendeve kryesore me orientim perëndimor, të cilat kanë qenë objekt hulumtimi. Mirëpo, para se të kalojmë te kjo pjesë, që më pastaj pasohet nga përvoja e **Gjykatës Kushtetuese të Kosovës** (**GJKK**), në vijim shprehim disa mendime lidhur me llojet e argumenteve të përdorura. Lidhur me llojeve të argumenteve që përdoren për formimin e strukturave argumentuese si më sipër, në hulumtimet krahasimore është vërejtur se janë përdorur (ose janë refuzuar për t'u përdorur) më së shumti, **inter alia**, argumentet për sa vijon:[138]

- analogjia (me qëllim të konfirmimit ose kontestimit të parametrave nga teksti pozitiv kushtetues);

[137] Hulumtimi më gjithëpërfshirës deri më sot lidhur me arsyetimin kushtetues dhe strukturën e llojet e argumenteve kushtetuese të përdorura gjendet në librin Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*. Ky libër, i bërë si rezultat i punës ekipore disa vjeçare të gjyqtarëve kushtetues dhe akademikëve nga lëmi i të drejtës dhe gjyqësisë kushtetuese të botës juridike perëndimore, bazohet në hulumtimet e thella me kombinim të metodologjisë kualitative dhe kuantitative të vendimmarrjeve, të strukturës, formës, stilit dhe gjuhës së arsyetimit të argumenteve kushtetuese. Këto tri lloje të strukturave të argumentit kushtetues i kemi nxjerrë nga pyetësori i këtij hulumtimi, i cili gjendet në faqet 798-820 të librit, me titull "shtojca". Të njëjtit iu kemi përmbajtur gjatë tërë punës sonë për këtë libër, për aq sa kjo ka pasur të bëjë me trajtimin e aspekteve praktike të vendimeve kushtetuese, strukturën dhe llojet, përfshirë këtu praktikën e **Gjykatës Kushtetuese të Kosovës**.

[138] Në gjykatat kushtetuese nëpër botë, përfshirë **Kosovën**, përdorimin lloj-lloj argumentesh për të arsyetuar vendimet e tyre, duke u njohur disave forcë dhe besim më të fuqishëm kundrejt tjerëve. Në gjyqësi kushtetuese, çështja me e diskutueshme ka të bëj me argumentet që burojnë nga interpretimi i vlerave dhe parimeve kushtetuese, i shpirtit dhe frymës së tekstit kushtetues, për çka edhe shërbejnë çdoherë si një strehë dhe nxitës i aktivizmit gjyqësor. Kjo për shkak se shpirti e fryma e një teksti kushtetues, zakonisht ankorohen në vlera e parime kushtetuese, jo në dispozitat operative. Këto vlera e parimeve kushtetuese interpretohen duke u bazuar në **analogji**, në të **drejtën e huaj** dhe faktorë **ekstra – juridik**, të cilat, së bashku, nuk mund të mos çojnë në aktivizëm gjyqësor dhe ndërtim të koncepteve që nganjëherë shkojnë kundër dispozitave operative kushtetuese. Këto dhe çështjet tjera lidhur me këtë i kemi diskutuar në kapitullin e katërmbëdhjetë, ashtu që më nuk i kthehemi kësaj teme. Këtu fokusohemi më shumë në **strukturën e argumentit kushtetues**.

- epërsia e zbatueshmërisë së kushtetutës nacionale kundrejt dokumenteve të tjera (p.sh. epërsia e të drejtës evropiane kundrejt kushtetutave nacionale, doktrina e çështjes politike, argumentet që thonë se interesi shtetëror ka përparësi në rastet e gjendjeve të jashtëzakonshme etj.);
- kuptimi i zakonshëm i termave të kushtetutës ose argumentimi i prodhuar përmes referimit në kuptimin e gjithmbarshëm të termave kushtetues;
- argumentet harmonizuese (argumentet me origjinë nga e drejta vendore ose nga e drejta ndërkombëtare/e drejta e Bashkimit Evropian);
- precedentet vetanake;
- analiza doktrinare e parimeve dhe koncepteve juridike;
- argumentet nga heshtja, përkatësisht argumentet e fituara përmes mënyrave konkludente të arsyetimit;
- argumentet teleologjike/qëllimore me pikë referimi qëllimin e vetë tekstit që zbatohet;
- argumentet teleologjike/qëllimore me pikë referimi qëllimin e kushtetutëbërësit (në rend të parë argumentet që rrjedhin nga ***travaux préparatoires***);
- argumentet e natyrës jo-juridike (morale, sociologjike, ekonomike etj.);
- referimi në punimet dhe veprat e shkruara të dijetarëve të shkencës juridike;
- referimet në të drejtën e huaj etj. etj.

Trajtimi i përvojave të shteteve konkrete në fushën e strukturës argumentuese të vendimeve e nisim me **Afrikën e Jugut**, një vend që ka sistem juridik hibrid, ku ekziston një gjykatë e ndarë kushtetuese me juridiksion të qartë kushtetues, e modeluar sipas sistemit evropian/kelsenian, mirëpo ku, në të njëjtën kohë, roli i gjyqtarëve në krijimin e të drejtës është krejtësisht i mbështetur në sistemin e të **drejtës së përgjithshme**. Kjo nënkupton se gjyqtarët, përfshirë këtu gjyqtarët kushtetues, përmes precedenteve marrin pjesë në formësimin e produkteve të parlamentit por, në të njëjtën kohë, edhe në formimin e normave të reja përmes doktrinës së precedenteve. Kjo e jep arsyen se përse struktura argumentuese e vendimeve të **Gjykatës Kushtetuese të Afrikës së Jugut** (**GJKAJ**) është jo-zinxhirore, përkatësisht pse vendimet e saj dominohen nga strukturat argumentuese që kanë stil dialogues dhe herë - herë edhe stil këmbët e karriges. Edhe në literaturë është vërejtur se kanë qenë roli dhe efekti normëvënës i precedenteve të gjyqtarëve në sistemin juridik-kushtetues afrikan ato që kanë diktuar strukturën e vendimeve në gjyqësinë kushtetuese. Kjo nënkupton se ky roli gjyqtarëve dhe arritja e efektit normëvënës të precedenteve nuk mund të shprehet pos përmes strukturave të komplikuara argumentative që kanë përmbajtje të komplikuara arsyetuese.[139]

Ajo që duhet ditur për **Gjykatën e Lartë të Australisë** (**GJLA**) lidhur me traditën e argumentimit të vendimeve lidhet me ndikimin e vazhdueshëm të metodës juridike me origjinë nga e **drejta e përgjithshme**: premisë themelore e kësaj metode është **doktrina e precedentit**, ku vetë precedenti është burim i së drejtës për rastet e ardhshme, duke u lexuar nga afër më pastaj dhe duke shërbyer si bazë e vendimmarrjes së ardhshme.

Në këtë traditë të ndikuar kësisoj, struktura dominante e argumentit kushtetuese pranë **GJLA** është **struktura e argumenteve kushtetuese me një rresht** ("**rrathët lidhës zinxhiror**"). Kjo është kështu pikërisht si pasojë e ndikimit të traditës së pastër së **drejtës së përgjithshme**, ku gjykatat nuk vendosin më shumë se që duhet dhe nuk japin arsyetime të tjera jashtë atyre të domosdoshme për zgjidhjen e rastit. Shih për këtë, në arsyetimin e vendimeve të **GJLA** argumentet që kanë strukturën e "**këmbëve të karriges**" nuk përdoren shumë, përkundër faktit që avokatët dhe përfaqësuesit e palëve kanë shumë prirje për të parashtruar shumë lloje të argumenteve për të provuar thëniet dhe pretendimet e tyre kushtetuese gjatë shqyrtimit të një rasti apo mosmarrëveshje konkrete kushtetuese.[140]

---

[139] Christa Rautenbach and Lorens Du Plessis, "The Constitutional Court of South Africa". Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning,* fq. 560-603 në fq. 576-577.

[140] Cheryl Saunders and Adrienne Stone, "The High Court of Australia". Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 36-74 në fq. 45-47.

Kjo nuk është shumë ndryshe në gjyqësinë kushtetuese austriake, përkundër faktit që ky vend ka një traditë të gjatë të gjyqësisë së tillë: **Gjykata Kushtetuese e Austrisë** (**GJKAu**) në historinë e saj ka kaluar nëpër dy lloje të argumentimit kushtetues. I pari lloj, i njohur si stili i vjetër, i takon kohës së viteve ndërmjet të dy luftërave botërore dhe përgjatë viteve ’50 dhe 70 të shekullit të kaluar, kurse i dyti lloj, i njohur si stili i ri, aktualisht dominon vendimmarrjen kushtetuese që nga vitet ’80 të shekullit të kaluar. Këto dy stile të vendimeve kanë kushtëzuar edhe strukturën e argumentit kushtetues dhe narrativin e tij.[141]

Stili i ri është bazuar në formalizëm të tepruar dhe në interpretim të fjalëve të Kushtetutës ashtu siç paraqiten ato në tekst: vetëpërmbajta gjyqësore e bazuar në mbrojtjen objektive të Kushtetutës, të hierarkisë së normave dhe parimit të legalitetit janë bazuar në premisën sipas së cilës ajo është një akt jo-politik që përcakton procedurat e udhëheqjes me shtetin dhe asgjë tjetër. Si një shprehje e kësaj praktike gjyqësore përmendet teoria e a.q. **petrifikimit** apo **e ngrirjes** sipas së cilës fjalët kanë po atë kuptim që ato e kanë pasur në momentin e nxjerrjes së normave mbi ndarjen e kompetencave në mes të federatës dhe “**land**”-eve austriake. Çdo ndryshim i mëvonshëm i normave nuk ka asnjë rëndësi për interpretim të tyre. Kjo qasje teorike akoma vlen në arsyetimet e **GJKAu**, por në një mënyrë pak më fleksibile, në veçanti kur bëhet fjalë për ndarjen e kompetencave në mes të federatës dhe “**land**”-eve.

Ky stil nisi të ndryshojë në vitet ’60 kur **Austria** e bëri **KEDNJ** pjesë të së drejtës së vet kushtetuese. Me këtë domosdo që ka ndryshuar edhe vetë arsyetimi i vendimeve të **GJKAu**. Ky ndryshim, në të njëjtën kohë, shënon fazën e lindjes së stilit të ri, që kryesisht lidhet me interpretimin e dispozitave të **KEDNJ**, përkatësisht të dispozitave mbi liritë dhe të drejtat kushtetuese të austriakëve. Tani e tutje, arsyetimi bazohet në vënien në jetë të parimit të proporcionalitetit, gjë që nuk mund të kufizohet në fjalitë (kuptimet) me të cilat formulohet një liri apo e drejtë. Kjo nënkupton se me rastin e interpretimit të lirive dhe të drejtave kushtetuese merret parasysh qëllimi, e kjo do të thotë se interpretimi teleologjik fiton një peshë të madhe. Kjo është kështu sepse nuk bëhet fjalë vetëm për respektimin e formës apo të anës juridike të fjalive, por edhe të vetë qëllimit primar – mbrojtja efektive e lirive dhe të drejtave kushtetuese, krahas ofrimit të garancioneve të caktuara procedurale. Të kuptuara kësisoj, të drejtat e liritë kushtetuese janë edhe vlera që detyrojnë ligjvënësin për respektim jo vetëm të anës procedurale legjislative. Në fund, arsyetimi kushtetues i bazuar në liritë dhe të drejtat kushtetuese ka çuar në zgjerimin e caqeve të të drejtave dhe lirive kushtetuese dhe në zhvillimin gjyqësor të kuptimit të tyre praktik. Përveç **KEDNJ**, në ndryshimin apo në rafinimin e stilit të ri të arsyetimit kushtetues në praktikën e **GJKAu**, një rol të madh ka luajtur edhe e drejta evropiane, ndaj të cilës **Austria** ka një raport shumë miqësor dhe të hapur. Të gjitha këto zhvillime kanë zhvendosur gjyqësinë kushtetuese austriake nga pozicioni i saj fillestar kelsenian, dogmatiko-pozitivist, në një pozitë më aktive kundrejt mbrojtjes dhe promovimit efektiv të parimeve dhe vlerave kushtetuese, në rend të parë të atyre që kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat e njeriut por edhe lidhur me parimin e barazisë, sundimin e ligjit dhe kështu me radhë.

Për dallim nga **GJKGje** dhe pranimit nga ajo të një stili të ri të arsyetimit të parimeve dhe vlerave kushtetuese, **GJKAu**, megjithatë, ka një stil mjaft të shkurtër të arsyetimit të vendimeve të saj, me një narrativ shumë jo-emocional dhe prozaik ku dominon **struktura e argumenteve kushtetuese me një rresht** (“**rrathët lidhës zinxhirorë**”). Kohëve të fundit, vendimet kanë tendencë për të pasur më shumë argumente konslusive, veçanërisht kur bëhet fjalë për ankesat kushtetuese ndaj vendimeve administrative lidhur me shkeljen e lirive dhe të drejtave kushtetuese me akte administrative të shtetit ose me ligj në të cilën bazohet akti administrativ cenues i këtyre lirive dhe të drejtave kushtetuese.

Një strukturë argumentative të ndryshme nga dy rastet e sipërme e gjejmë në praktikën gjyqësore të **Tribunalit Suprem Federal në Brazil** (TSFB): stili i punës këtu, në parim, është jo-deliberativ dhe individualist, gjë që paraqet pasojë të kulturës juridike në të cilën shkruhet tepër gjatë me shpërfaqje konstante të një dije dhe erudicioni të tipit enciklopedik nga ana e gjyqtarëve individual. Kjo diktohet edhe nga lloji i vendimit dominant, i njohur si **seriatim**, në të cilin nganjëherë, për shkak të gjatësisë, mund të shpërfaqen disa struk-

[141] Konrad Lachmayer, “The Austrian Constitutional Court”. Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 75-114 në fq. 88-93.

tura argumentative. Marrë në tërësi, megjithatë, dominon struktura jo-dialoguese, përkatësisht vendimet me strukturë argumentuese kumulative ("**argumenti këmbët e karriges**"). Kjo, në thelb, është vetë natyra e vendimeve **seriatim**, ku secili argumentim ka një strukturë të pavarur nga tjetri dhe çon në të njëjtin përfundim si argumenti tjetër i dhënë.[142]

Në **Gjykatën Supreme të Kanadasë (GJSKa)**, tradicionalisht ka dominuar argumentimi i bazuar në arsyetimin strukturor të "**këmbëve të karriges**", e shumë më pak ai dialogues. Secili argument i dhënë, në të shumtën e rasteve, konsiderohet i mjaftueshëm për të dhënë përgjigje në çështjen apo mosmarrëveshjen e ngritur kushtetuese, dhe atë në një mënyrë kumulative dhe paralele. Llojet tjera të argumentimit, në veçanti ato që bazohen në **strukturën dialoguese argumentuese**, janë më të rralla. Në literaturë, **struktura e argumenteve me një rresht** konsiderohet si tepër e thjeshtë për të adresuar ndërlikueshmërinë e rasteve të parashtruara për gjykim dhe vendosje. Arsyeja për këtë diversitet në strukturën e argumentit kushtetues kanadez përcaktohet nga fakti se nuk ekziston një instrument kushtetues, asnjë, që do të tregonte qartë se cili nga argumentet e dhëna ka fuqi dhe vlefshmëri më të madhe krahasuar me tjerët. Ky fakt përbën esencën e përzgjedhjes eklektike të argumenteve gjatë interpretimit kushtetues në **GJSKa**.[143]

Një praktikë që shumë i ngjanë përvojës së **Kosovës** me gjyqësinë kushtetuese post-komuniste paraqet rasti i Çekisë. **GJK*Çe*** nxjerr aktgjykime që nisin me përshkrimin e shkurtër të rastit, pasuar nga prezantimi i argumenteve të palëve. Më pas fillon përshkrimi i saktë i fakteve të rastit (në veçanti kur bëhet fjalë për rastet e procedurave të iniciuara sipas ankesës kushtetuese, e cila ka natyrë të njëjtë si në Kosovë (ankesë e plotë). Kjo nganjëherë e bën aktgjykimin çek relativisht kaotik, thuhet në literaturë.[144] Arsyetimi i meritave të aktgjykimit më pas ndahet në disa seksione që përbëjnë meritat e rastit, ku **GJK*Çe*** për secilin argument të palëve jepet një arsyetim të saj, si dhe konkluzionet për secilin argument veç e veç. Kjo e bën të qartë stilin e argumentimit, përkatësisht strukturën e tij : kryesisht dominon argumenti "**këmbët e karriges**", e më pak **struktura e argumenteve me një rresht** ("**rrathët lidhës zinxhiror**").[145] Dominimi i strukturës argumentuese "**këmbët e karriges**" shpjegohet me faktin se kjo mënyrë arsyetimi ka të bëj me **silogjizmin**, i cili konsiderohet si nj model ideal i arsyetimit juridik në përgjithësi, përfshirë këtu të drejtën kushtetuese dhe gjyqësinë e saj.

Në rastet rutinë, të zgjidhshme lehtë dhe jo shumë të komplikuara, struktura e argumentit është kryesisht me një rresht apo me rrathët lidhës sikur zinxhiri, kurse në ato më të komplikuara dominon struktura "**këmbët e karriges**". Ky dominim shpjegohet me faktin se gjyqtarët çdoherë synojnë të sjellin përpara në vendimin e tyre sa më shumë argumente me qëllim që t'i bindin lexuesit dhe publikun për korrektësinë dhe legjitimitetin e vendimmarrjes konkrete. Një rast që reflekton këtë gjendje të gjërave dhe që zihet në gojë në literaturë është **Evropean Arrest Warrant Case**: në këtë aktgjykim, **GJK*Çe*** ka përdorur disa vija të pavarura argumentimi për të arsyetuar pse nuk është jo kushtetuese ekstradimi i shtetasve çek mbi bazën e urdhrit evropian për arrest. Një shembull tjetër që zihet në gojë në literaturë ka të bëjë me të njëjtin diskutim si më sipër lidhet me lirinë e shprehjes. Në këtë rast, **GJK*Çe*** *në fillim ka përdorur* **strukturën e argumenteve me një rresht** ("**rrathët lidhës zinxhiror**") për të kritikuar gjyqësorin e rregullt për mosbalancim të lirisë së shprehjes dhe privatësisë, për të kaluar më pastaj në përdorimin e një mori argumentesh të pavarura me qëllim të argumentimit se personi i kritikuar në publik kishte qenë një figurë publike, fakt që në vetvete shkakton nivel më të ulët të mbrojtjes së të drejtës për privatësi.[146]

---

[142] Conrado Hubner Mendes, "The Supreme Tribunal of Brasil". Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 115-153 në fq. 132-136.

[143] Hugo Cyr and Monica Popesku, "The Supreme Court of Canada". Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 154-198 në fq. 169-171.

[144] *Zdeněk Kühn, "The Constitutional Court of the Czech Republic"*. Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 199-236 në fq. 212.

[145] Një ndikim të madh në këtë strukturë argumentuese kanë luajtur shkencëtarët çek që kanë shërbyer në **GJK*Çe*** në mandate të ndryshme si gjyqtarë dhe kryetarë të saj, si dhe ndikimi që ka pasur gjyqësia kushtetuese gjermane në këtë vend. Ibid., fq. 212.

[146] Ibid., fq. 212-213.

Sa i përket vendimeve që arsyetohen me përdorimin e **argumenteve me strukturë dialoguese**, të cilat janë shumë të rralla në praktiken e **GJK*Çe***, vlen të veçohet rasti i kontrollit kushtetues të dekreteve presidenciale që kanë pasur për objekt marrjen (heqjen) e shtetësisë çekosllovake gjermanëve dhe hungarezëve etnik pas **Luftës së Dytë Botërore**, veprim që ka rezultuar në dëbimin e tyre dhe humbjen e pronave. Ky rast është nisur me ankesë kushtetuese të një gjermani etnik, dikur shtetas çekosllovak, i cili kërkoi anulimin e dekreteve presidenciale të pas Luftës së Dytë Botërore dhe rikthimin e pronave të humbura pa të drejtë. Me këtë rast, **GJK*Çe*** *shkroi një vendim shumë të gjatë me të cilin provoi të kryej një rivlerësim të historisë nacionale. Kjo rrethanë e bën këtë vendim atipik, jo të zakonshëm për një tekst juridik: argumentet pasionante të përdorura në vendim, më shumë i ngjasojnë një mbrojtjeje historike të veprimeve të qeverisë së* **Çekosllovakisë** pas **Luftës së Dytë Botërore**. Në vend të kësaj, **GJK*Çe është dashur të mbahet pas kompetencave juridiksionale që nuk lejojnë kontrollin kushtetues të akteve juridike që nuk janë në fuqi dhe që nuk zbatohen më, pasojat juridike të të cilave janë prodhuar dhe kanë kryer efektet e tyre pesëdhjetë vite më herët.*** **GJK*Çe****, megjithatë, nuk e ka bërë një gjë të tillë. Kjo ka ndodhur si rezultat i natyrës së vetë* ***argumenteve më strukturë dialoguese****, të cilat zakonisht përdoren si rezultat i paaftësisë së gjykatave apo të gjyqtarëve për të shkruar vendime duke prodhuar argumente koherente që i përshtaten modelit të strukturës së* ***argumenteve*** **me një rresht** ("**rrathët lidhës zinxhiror**") ose argumenteve që kanë strukturën "**këmbët e karriges**". Kjo nënkupton se, modeli dialogues rrjedh si pasojë e paaftësisë për të qenë koherent në argumentim, përkatësisht për shkak të paaftësisë për të operuar si duhet me teknikën e silogjizmit *me rastin e interpretimit juridik. Në vend të kësaj vjen deri te hapja e rrugëve arsyetuese në vendim dhe dhënia e argumenteve që nuk kanë ndonjë relevancë me rastin. Në* ***Kosovë,*** *si shembull tipik i këtij modeli të argumentimit dialogues, konfuz dhe jokoherent, është Aktgjykimi i* ***Gjykatës Kushtetuese*** *lidhur me rastin e* ***Asociacionit Serb****.*

Si një gjykatë më funksion të dyfishtë, si gjykatë kushtetuese që vë standarde garantuese të mbrojtjes minimale të lirive dhe të drejtave të garantuara me **KEDNJ** dhe si mbikëqyrës i vënies në jetë të kësaj konvente, **Gjykata e Strasburgut** në kontekstin kushtetues kosovar gëzon një status të veçantë dhe ka një peshë jashtëzakonisht të madhe kushtetuese: nenit 53 i Kushtetutës, tani më i njohur për të gjithë, e cakton si një detyrim për të gjitha autoritetet publike që me rastin e vendosjen për liritë dhe të drejtat kushtetuese vendimet e tyre t'i bazojnë në tërësi në interpretimet e bëra në **Strasburg**, pra në harmoni të plotë me standardet e vëna nga **GJEDNJ.**[147] Ky fakt i vetëm mjafton për të trajtuar **Gjykatën e Strasburgut** edhe në aspektin e patrajtuar deri më tani – atë të strukturës argumentuese të arsyetimeve të vendimeve të saj dhe të llojit të argumenteve të përdorura aty. Së pari diskutojmë llojin e argumentit dhe parimet mbi të cilat bazohet vendimmarrja, për të kaluar më pas në strukturën e argumentit kushtetues.

Në arsyetimin e saj me karakter kushtetues, të përshkruar si më lartë, **Gjykata e Strasburgut** i përmbahet disa parimeve themelore.[148] I pari ndër to është parimi sipas të cilës **KEDNJ** është një **instrument i gjallë**. Kjo nënkupton se me rastin e interpretimin të dispozitave të normave të Konventës, të parimeve dhe vlerave që ato mishërojnë, **GJEDNJ** i qaset interpretimit evolutiv dhe dinamik, të bazuar në konsensus maksimal. Për Konventën si një **instrument i gjallë** kemi folur më herët, ashtu që këtu do ndalemi vetëm me kaq.[149]

Në vijim si më sipër, parimi i dytë me radhë është **parimi i efektivitetit dhe i interpretimit meta-teleologjik**: sipas praktikës së **Gjykatës së Strasburgut** objektivi qendror i Konventës është garantimi i lirive dhe të drejtave themelore të individëve në një mënyrë praktike dhe efektive. Këtij qëllimi qendror, **GEDNJ** i jep formë përmes leximit të dispozitave të saj në atë mënyrë që çdoherë të respektohen parimet themelore të mishëruara në të, siç janë, ta zëmë, parimi i respektit për dinjitetin njerëzor, i autonomisë

147 Neni 53 ["Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut"] i Kushtetutës:
"Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut."

148 Jannke Gerards, "The Euroepan Court of Human Rights". Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 237-276 në fq. 255-259.

149 Cf. më shumë në seksionin 14.2 të kapitullit katërmbëdhjetë.

personale, i demokracisë dhe sundimit të ligjit, i pluralizmit të ideve dhe marrëdhënieve pronësore etj. Kjo formë ndërtohet vetëm përmes zbatimit të interpretimit meta-teleologjik, jo duke ngarendur në mënyrë dogmatike pas kuptimeve literale të normave të Konventës.

Parimi i tretë me radhë është një lloj përzierje e parimeve si vijon: parimi i përparësisë së shteteve për mbrojtjen dhe promovimin e lirive dhe të drejtave të garantuara me **KEDNJ**; parimi i subsidiaritetit të **Gjykatës së Strasburgut**, e cila shërben vetëm si një mbikëqyrëse e zbatimit të dispozitave të Konventës; dhe, së fundi, parimi se "argumenti më i mirë" prodhohet në nivel nacional ngaqë autoritetet zbatuese të Konventës, shtetet anëtare, janë në pozitë më të mirë për të njohur rrethanat dhe traditat lokale (kjo përbën thelbin e doktrinës së "vlerësimit të lirë", si përcaktuese e intensitetit të kontrollit kushtetues që **Gjykata e Strasburgut** e ushtron ndaj vendimeve të shteteve anëtare).

Parimi i katërt me radhë është **parimi i interpretimit autonom të termave** si "privatësia", "prona" ose termi "gjykatë", të cilat në nivele nacionale kanë kuptime e konotacione të ndryshme. Me interpretim autonom nënkuptohet interpretimi i këtyre termave dhe i termave të tjerë të cilët i jep **Gjykata e Strasburgut** me qëllim të gjetjes së një rruge të mesme dhe një terminologjie neutrale që reflekton standardin mesatar të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të garantuara me Konventë.

I fundit, parimi i pestë, përbëhet prej dy parimeve: parimi i arsyetimit të bazuar në precedente dhe parimi i mënyrës graduale të rritjes së precedenteve. Kjo nënkupton që **Gjykata e Strasburgut** vendos lidhur me rastet kryesisht duke u bazuar në krahasimin e fakteve të rastit që duhen përzgjedhur me faktet e rastit apo të rasteve të vendosura në të kaluarën nga vetë ajo, duke kërkuar gjetjen e analogjive, ngjashmërive dhe dallimeve. Kjo nënkupton se vendimmarrja me efekt precedenti është e ngadalshme dhe graduale.

Sa i përket strukturës së argumentit kushtetues, **GJEDNJ** në të shumtën e vendimeve të saj në fillim mbarështon analizën e parimeve që i ka nxjerrë (krijuar) në vendimmarrjet e saj nga e kaluara, parime që janë të lidhura me tema të njëjtë. Më pas në vendim sqaron se i zbaton parimet e tilla në rastin që e ka përpara. Shikuar në aspektin **silogjistik**, premisa e epërme ("premisa major") është parimi apo parimet nga e kaluara që lehtë mund të gjejnë zbatim në rastin konkret që pret për t'u shqyrtuar dhe vendosur, kurse premisën e poshtme ("premisa minor") në këtë mes e përfaqëson vetë rasti në të cilin pohohet shkelja (cenimi) i dispozitave të caktuara të **KEDNJ** (i cili rast paraqet gjendje fakti dhe pohim për shkelje të dispozitave të **KEDNJ**). Kjo nënkupton se nënvënia (subsumimi) e premisës së poshtme ndaj të sipërmes e prodhon konkluzionin përkatës lidhur me cenimin e dispozitave të **KEDNJ.** Në këto lloje të vendimeve, struktura e argumentit kushtetues është relativisht lineare për nga natyra (**strukturë e drejtë zinxhirore**).

Kjo si më sipër, megjithatë, nuk është rruga standarde të cilën e ndjek **GJEDNJ** në rastet tjera. Jo rrallë, ajo konstaton se parimet si më sipër që përbëjnë premisën sipërme ("premisa major") nuk janë të mjaftueshme, ashtu që me rastin e vendosjes duhet të ndërtohen parime e premisa të reja të interpretimit. Kjo në të shumtën e rasteve bën që, si pasojë e parimeve dhe premisave të reja, të cilat ndërtohen përtej atyre të gjetura në precedentët e mëhershëm, argumentimi i përdorur nga **GJEDNJ** të ketë një strukturë më të gjatë, me argumente të njëjta që çojnë në të njëjtin përfundim. Një rrethanë e tillë, për pasojë, prodhon vendime që kanë strukturë jo – zinxhirore: struktura "**këmbët e karriges**" ekziston atëherë kur përdorimi i argumenteve të ndryshme çon në përfundim të njëjtë. Kjo strukturë, që duket të jetë dominuese, konsiston në atë që **GJEDNJ** identifikon një grumbull faktorësh autonom që duhet të merren parasysh me rastin e vlerësimit të shkeljes së të drejtave dhe lirive të garantuara me Konventë, pa dhënë një mendim se cili nga argumentet e paraqitura ka peshën më të madhe. Në literaturë, kjo qasje argumentative është cilësuar si një **ekuilibër reflektiv**, përkatësisht si një qasje që me rastin e vendimmarrjes shkon herë prapa e herë para, duke i rivlerësuar parimet e vjetra dhe ato të reja me qëllim të definimit të koncepteve bazë të Konventës. Në fund shikohet se si të gjitha këto parime dhe koncepte gjejnë zbatim praktik në rastin konkret që vendoset.[150]

[150] Jannke Gerards, "The European Court of Human Rights". Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 259-260.

Sa i përket strukturës së argumentimit dhe vetë arsyetimit kushtetues, një gjykatë tjetër evropiane, **Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian** (**GJED)** me seli në **Luxemburg**, nuk dallon shumë nga **GJEDNJ**. Ka rëndësi për lexuesin t'i themi disa fjalë në këtë drejtim, duke veçuar disa specifika që çojnë peshë të veçantë, siç janë, ta zëmë, specifikat lidhur vendimet që duket se kanë **natyrë dialoguese**, por që nuk është ashtu, pastaj specifikat lidhur me dallimin ndërmjet vendimeve që dominojnë vendimmarrjen në këtë institucion të lartë të drejtësisë dhe atyre që nuk janë në numër aq të madh etj. etj. E njëjta gjë vlen edhe për specifikat tjera që kanë të bëjnë me kuptimin e fjalëve "kushtetutë" dhe "gjykim apo kontroll kushtetues" në kontekstin e kontrollit kushtetues në hapësirën evropiane të së drejtës. Kjo ka bërë që në literaturë, me plot të drejtë, **GJED** të cilësohet si një gjykatë **sui generis**, për shkak se ajo ushtron funksione të kontrollit kushtetues (për aq sa kjo ka të bëj me sigurimin e supremacisë së legjislacionit primar në **BE**, funksione të kontrollit administrativ (për aq sa kjo ka të bëj me kontrollin e ligjshmërisë së punës së organeve administrative dhe burokratike të **BE**-së), funksione të një gjykate ndërkombëtare (për aq sa kjo ka të bëj me kontrollin nëse vendet anëtare po veprojnë në harmoni me **Traktatet**) dhe, në fund, funksione të një gjykatë supreme (për aq sa kjo ka të bëjë me sigurimin e zbatimit uniform të së drejtës evropiane në tërë territorin e **BE**-së).[151]

Në literaturë bëhet dallimi në mes të arsyetimit kushtetues në kuptimin e ngushtë (**stricto sensu**) dhe arsyetimit kushtetues në kuptimin e gjerë (**sticto latu**), të cilat **GJED** i përdor me rastin e vendosjes për mbarë hapësirën e **BE**-së.

GJED kryen kontroll kushtetues të arsyetuar me terma që kanë bazë në të drejtën kushtetuese dhe ndërkombëtare, me pikë referimi **Traktatet**,[152] me qëllim të përcaktimit të vlefshmërisë se legjislacionit sekondar të UE-së. Si legjislacion primar me fuqi kushtetuese nënkuptohen vetëm **Traktatet** e marra si tërësi. Kjo është kuptimi i ngushtë, **stricto sensu**, i arsyetimit kushtetues. Vendimmarrja këtu ka bëj me anulimin dhe me procedurat e referimit incidental. Në dy rastet **GJED** vepron si një gjykatë kushtetuese në kuptimin e ngushtë, **stricto sensu**, për arsye se si pikë referimi shërbejnë **Traktatet**, të cilat janë "norma apo grupe normash që kanë vlerën më të lartë brenda rendit juridik në kuptim që vlefshmëria e të gjitha normave tjera matet mbi bazën e tyre".[153] Se Traktatet kanë një fuqi me karakter të theksuar kushtetues e ka thënë vetë **GJED** në një vendim të saj në vitin tanimë të largët 1986, i rikonfirmuar më pastaj në vitin 2008: në rastet **Les Verts** (1986) dhe **Kadi** (2008) u potencua në mënyrë solemne se **Traktatet** paraqesin dokumente juridike me karakter themelor kushtetues të një shoqërie që bazohet në sundim të ligjit.[154] Në këtë kuptim, arsyetimi kushtetues i referohet ekskluzivisht arsyetimit që ka për bazë tekstin e **Traktateve**, interpretimeve dhe saktësimeve të kuptimeve të përmbajtjes së tyre.[155]

---

151 Giulio Itzcovich, "The European Court of Justice". Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 277-322 në fq. 278-279.

152 Me **Traktate** nënkuptohen instrumentet si vijon (sipas vjetërsisë së tyre) :

- Traktati i Lisbonës (2007);
- Traktati i Nicës (2004);
- Traktati i Amsterdamit (1997);
- Traktati mbi Unionin Evropian apo Traktati i Mastrihtit (1992);
- Akti i Veçantë Evropian (1986);
- Traktati i Brukselit apo i Shkrirjes (1965);
- Traktatet e Romës (1957); dhe, në fund,
- Traktati mbi Themelimin e Komunitetit të Qymyrit dhe Çelikut (1951). Për veçoritë e tyre kushtetuese si dhe për rolin e **GJED** si institucion me mandat për dhënien e interpretimeve kushtetuese, cf. më shumë në Thomas Horsley, *The Court of Justice of the European Union as an Institutional Actor : Judicial Lawmaking and Its Limits* (Cambridge Unioversity Press: Cambridge, 2018) fq. 21-59 (ky libër, marrë si tërësi, argumenton se **Traktatet** përbëjnë themelin kryesor për vlerësimin e kushtetutshmërisë së brendshme të **UE**-së dhe të legjitimitetit të ekzistencës dhe funksionimit institucional, përfshirë **GJED**; veç kësaj, libri hulumton se sa **GJED** si institucion i përmbahet kuadrit juridik të përcaktuar me **Traktate** gjatë ushtrimit të funksioneve të saj interpretative).

153 Giulio Itzcovich, "The European Court of Justice". Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 279.

154 Ibid., fq. 289 (fusnota nr. 32 dhe teksti që e shoqëron).

155 Ibid., fq. 290.

GJED prodhon arsyetim kushtetues në kuptim të gjerë, **stricto latu**, atëherë kur analizon "vlefshmërinë evropiane" të legjislacionit dhe praktikave nacionale, përkatësisht kur interpreton të drejtën evropiane përmes procedurave të kontrollit preliminar (incidental). Këtu objekti i interpretimit nuk kufizohet vetëm në **Traktate**, por përfshinë tërë korpusin e të drejtës evropiane. Ky juridiksion kushtetues i **GJED** nuk është ekskluziv, suprem dhe as i drejtpërdrejtë, për shkak se është i domosdoshëm intervenimi i gjykatave nacionale me qëllim të largimit të konfliktit në mes të të drejtës nacionale dhe asaj evropiane. Në rastin e parë, përkatësisht në sferën e prodhimit të arsyetimit në kuptimin e ngushtë, **stricto sensu,** një intervenim i tillë nuk është kusht i domosdoshëm. Sidoqoftë, në dy kuptimet, **GJED** shërben si një gjykatë kushtetuese, si njëra prej gjykatave kushtetuese në truallin e vendeve të **BE**-së, pa pasur një pozicion vertikal hierarkik, gjë që e bën këtë institucion të ketë vërtetë një natyrë specifike **sui generis**. Kjo natyrë **sui generis** buron nga një zhvillim specifik i semantikës juridiko-kushtetuese evropiane, i cili reflekton jetën e konstitucionalizmit evropian brenda vendeve anëtare të **BE**-së, kulturat politike dhe kushtetuese të të cilave kanë një afri aq të madhe sa mungesa e një teksti të shkruar kushtetues të kodifikuar nuk paraqet ndonjë pengesë serioze. Sigurimi i supremacisë (epërsisë) së **Traktateve** dhe krejt korpusit të së drejtës evropiane marrë si tërësi përbën cilësinë dalluese të konstitucionalizmit brenda **BE**-së dhe të arsyetimit kushtetues që prodhohet aty. Në literaturë kjo gjendje me plot të drejtë është quajtur **konstitucionalizëm funksional**.[156]

Sa i përket strukturës së argumenteve kushtetuese, dominon struktura "**këmbët e karriges**", e cila bashkëjeton me një numër jo fort të vogël të vendimeve me "**strukturë argumentuese zinxhirore**". Sa i përket "**strukturës dialoguese**", vlen të theksohet se ajo është diskursive dhe jo dialoguese, gjë që rrjedh si pasojë e faktit se **GJED**, në raste shumë të rralla, paraqet vija argumentuese me qëllim të përforcimit të pozitës së vet. Kjo bëhet duke shtuar disa argumente me qëllim të arritjes së një përfundimi të dhënë dhe jo për të krijuar një dialog me lexuesin apo me publikun e gjerë. Si rast i këtij argumentimi diskursiv, në literaturë përmendet rasti **Van Gend en Loos** (1963), nga i cili shkëpusin një pasazh të shkurtër:

"[...] Kjo pikëpamje konfirmohet nga Preambula...; Po ashtu konfirmohet në mënyrë edhe më specifike nga themelimi i institucioneve të veshura me të drejta sovrane...; Për më tepër, duhet vënë në spikamë se shtetasit e shteteve anëtare... janë të ftuar për të bashkëpunuar me qëllim të funksionimi të këtij komuniteti".[157]

Sikundër vërehet nga struktura e këtyre fjalive, këtu bëhet fjalë për një ton arsyetues që është shumë lakonik, mjeshtëror dhe shpërfaq argumente që janë paralele. Këto argumente kanë dy cilësi: e para, nëse merren individualisht, nuk flasin për asnjë përfundim; dhe, e dyta, kuptimi i tyre del vetëm nëse lexohen në mënyrë kumulative. E, thënë ndryshe, as Preambula, as themelimi i institucioneve dhe as gatishmëria e shtetasve të shteteve anëtare për të bashkëpunuar nuk tregojnë asgjë nëse lexohen në mënyrë të veçuar: vetëm nëse merren në konsideratë së bashku si argumente dhe vihen në një fjali mund t'u nxirret kuptimi i tërësishëm.

Asnjëra nga praktikat gjyqësore të trajtuara deri më tani nuk i ngjasojnë përvojës së **Francës** me **KKF**, si në aspektin e strukturës argumentuese dhe të arsyetimit kushtetues ashtu edhe për sa i takon llojit të argumenteve të përdorura. Në të vërtetë, në literaturë është vërejtur, lidhur me aspektin e fundit, se vendimet e **KKF** zakonisht karakterizohen për mungesë të tërësishme të argumenteve të llojit të caktuar, siç është rasti, ta zëmë, me mungesën e argumenteve të nxjerra (derivuara) përmes analogjisë apo citimit të veprave të dijetarëve të drejtësisë, të argumenteve që rrjedhin nga e drejta e huaj dhe e drejta

[156] Cf. më shumë për këtë në studimin e shkëlqyer të Turkuler Isiksel, *Europe's Functional Constitution. A Theory of Constitutionalism Beyond the State* (Oxford University Press: Oxford, 2016) (ku autori flet për të gjitha segmentet e këtij konstitucionalizmi, përfshirë këtu sferën e mbrojtjes dhe promovimit efektiv të lirive dhe të drejtave të njeriut, që realizohet në vendet anëtare të BE-së përmes shumë niveleve dhe mekanizmave të kontrollit implementues).

[157] Giulio Itzcovich, "The European Court of Justice". Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 292 fusnota nr. 36.

ndërkombëtare, nga precedentet vetanake, burimet e tjera ekstra-juridike dhe kështu me radhë. Në asnjë rast deri më sot **KKF** nuk është shërbyer me këtë lloj të argumenteve si më sipër.[158]

Ajo që e bën edhe më karakteristike arsyetimin kushtetues francez, konsiston në dominimin e strukturës argumentuese zinxhirore dhe mungesën e tërësishme të strukturës dialoguese argumentative. Kjo shpjegohet me traditën e gjyqësisë franceze në përgjithësi, e cila niset nga premisa e vjetër sipas së cilës gjyqtarët janë vetëm zbatues teknik të normës juridike kundrejt fakteve të lindura jetësore, fakte të cilave iu dedikohet norma që zbatohet dhe për të cilat bën fjalë ekskluzivisht. Kjo traditë ka rrënjët në **Francën** pas revolucionare, e cila asnjëherë nuk ka arritur të dal jashtë kornizës së saj formale, diskrete dhe të mjegullt të arsyetimeve gjyqësore, me një formalizëm të tepruar. Kjo qasje formaliste, ku rrallë herë bëhet fjalë për shpirtin e normës juridike dhe rolin kreativ të gjyqtarit, në literaturë është cilësuar si kuazi-silogjizëm, nisur nga fakti se vendimet e **KKF** fillojnë me formën formale të rezolutave të organeve ndërkombëtare apo të ndonjë preambule kushtetuese. Kjo duket si vijon:

" Këshilli Kushtetues,

a. Duke u nisur nga (pason citimi numerik i dispozitave përkatëse kushtetuese dhe i dispozitave nga tekstet tjera juridike)…;
b. Në ndërkohë që (pason qëndrimi i caktuar rreth objektit të kontrollit kushtetues që paraqet gjendjen faktike) ….;
c. Vendos (pason narrativi mbi zgjidhjen e rastit)".[159]

Në **pseudo-silogjizëm**, pjesa nën (a), dispozitat kushtetuese dhe dispozitat tjera juridike që merren në shqyrtim supozohet se përbëjnë premisën e sipërme (**premisa major**); pjesa nën (b), akti juridik apo ligji që është objekt i kontrollit kushtetues, supozohet që paraqet premisën e ultë (**premisa minor**); dhe, pjesa nën (c), vendimi mbi meritat e rastit, supozohet të paraqet një përfundim logjik. Tërë kjo ndodhë në një fjali të vetme të thjeshtë në kundrinë të drejtë. Si vëllim, ndërkaq, vendimet e **KKF** janë shumë të shkurtra dhe, siç u tha, tërësisht formale, diskrete dhe të bazuara në interpretime të papërcaktuara. Në literaturë është vërejtur se ekziston një vendim i dytë, jo zyrtar, që zakonisht bëhet i ditur përmes **press release**-ave të **KKF** dhe të cilin publiku e media e përçojnë tutje duke i dhënë një kuptim të kuptueshëm për tjerët.[160]

I vetmi përjashtim nga kjo strukturë argumentuese ka ndodhur në vitin 1962 me një vendim të **KKF** për referendumin: **Sharl de Gol** (**Charles de Gaulles**: 1890-1970), pas mbarimit të luftës në **Algjeri**, kishte vendosur për të ndryshuar mënyrën e zgjedhjes së shefit të shtetit, nga sistemi ekzistues i zgjedhjes përmes kolegjeve elektorale në një sistem të zgjedhjes së drejtpërdrejt nga populli. Për të bërë një gjë të tillë, atij i duhej ta merrte miratimin e **Parlamentit të Francës**, në mënyrë që më pastaj draft-amendamenti kushtetues të kalonte në referendum popullor. **De Gaul** kishte kaluar hallkën parlamentare, i bindur se aty nuk do t'i kalonte propozimi, duke e hedhur në referendum drejtpërdrejtë draftin e amendamentit që atij i jepte një mandat si shef shteti në një qeverisje semi-presidenciale. Këtë draft e kishte dërguar në **KKF** kryesuesi i **Senatit Francez**, me qëllim të kontrollit të tij kushtetues: **KKF**, megjithatë, kishte refuzuar të hyjë në meritat e rastit, duke dhënë një sërë arsyetimesh kushtetuese me strukturë argumentuese të tipit të **këmbët e karrigës**.[161] Të shohim si është dukur arsyetimi argumentativ në këtë rast.

Në rend të parë, **KKF** kishte thënë se draft-amendamenti kushtetues nuk binte në juridiksionin e tij, amendament që i referohej ekskluzivisht kontrollit kushtetues të vendimeve të autoriteteve publike, duke përjashtuar vendimet e sovranit të miratuara me **referendum**. Ky argument u nxor nga shpirti i Kushtetutës së vitit 1958. Si argument i dytë, sipas arsyetimit të **KKF**, u përdor fakti i mungesës së dispozitave

[158] Arthur Dyevre, "The French Constitutional Council". Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 323-355 në fq. 340-341.

[159] Ibid., fq. 336.

[160] Ibid., fq. 336-338.

[161] Ibid., fq. 338-339.

kushtetuese që përcaktojnë një tjetër procedurë në periudhën ndërmjet miratimit të draft-amendamentit me referendum dhe shpalljes së tij. Argumenti i tretë dhe i fundit, i pavarur i tipit **këmbët e karriges**, që u përdor në arsyetimin e këtij rasti ka pasur të bëjë me vetë ligjin organik që normon organizimin dhe punën e **KKF**: ky ligj njeh, në mënyrë shprehimore dhe pa dykuptimësi, vetëm juridiksionin e **KKF** për kontroll preventiv të ligjeve të miratuara nga Parlamenti, jo edhe të ligjeve që janë miratuar me referendum. Këto të fundit nuk i nënshtrohen kontrollit kushtetues. Sikundër shihet, secili nga këto argumente të përdorura frymojnë në mënyrë të pavarur dhe argumentojnë në mënyrë të njëjtë se përse **KKF** nuk ka pasur juridiksion për kontroll preventiv të draft-amendamentit të **Sharl de Gol** që kishte të bënte me ndryshimin e mënyrës së zgjedhjes së presidentit francez (tipi i strukturës argumentative **këmbët e karriges**, i sqaruar më sipër).

Një situatë e kundërt me praktikën e **KKF**, në fakt shumë më e ndryshme se krejt rastet që diskutuam deri këtu, paraqitet ajo me **GJKGje,** liria metodologjike e së cilës ka krijuar nga e drejta kushtetuese një udhëzues të pakontestueshëm për politikën, gjyqësorin dhe autoritetet tjera publike. Vendimet e saj në arsyetim paraqiten si deduktive dhe teknike, mirëpo operojnë, në të njëjtën kohë, me koncepte shumë të gjëra dhe të hapura që kanë një analizë qëllimore. Me përjashtim të viteve të para të punës, ajo ka arritur të krijojë një standard arsyetimi jashtëzakonisht të saktë dhe me struktura doktrinare të përpunuara deri në detaje, aq sa leximi dhe analizimi i vendimeve të saj duket si një çështje krejtësisht e lehtë dhe teknike. Në dëshmi të kësaj, mjafton të rikujtohen arsyetimet e **GJKGje** në vendimet lidhur me, ta zëmë, **kuptimin e lirisë si një e drejtë reziduale** (sipas së cilës liria çdoherë ka substancë të gjallë jashtë definimit tekstual kushtetues të kuptimit të lirisë), **efektet indirekte horizontale** të së drejtës kushtetuese gjermane bazuar në **Ligjin Themelor** (**LTH**) si një "rend objektiv i vlerave", dhe, së fundi, **analizën apo testin e proporcionalitetit**. Në veçanti dy doktrinat e fundit përbëjnë modelet më së shumti të eksportuara në botën e jashtme, të pranuara dhe të përqafuara nga shumë kushtetuta e gjykata kushtetuese.[162] Vendimet e saj kanë një vëllim më të madh se dikur dhe shërbejnë si udhëzues për ligjvënësin, gjyqësorin dhe për autoritetet tjera publike. Në këtë kuptim, **GJKGje** është shembulli më i mirë në botë për gjyqësinë kushtetuese. Të shohim si duket kjo në vijim.

Sa i përket strukturës së argumenteve kushtetuese, bazuar në traditën gjermane të shekullit XIX, **GJKGje** në përgjithësi i mbahet stilit silogjistik të argumentimit: në një mënyrë deduktive, në fillim ajo identifikon normat relevante, ndërton kuptimin dhe përmbajtjen e tyre duke u bazuar në teorinë dhe praktikën juridike nga e a kaluara dhe e tashmja. Në fazën e dytë, **GJKGje** i vë në jetë këto standarde ndaj rastit prezent, duke krahasuar arsyetimin e vendimit apo normës së mëhershme me standardet e krijuara rishtazi. Me zhvillimin e fuqishëm të **parimit apo testit të proporcionalitetit**, një produkt tipik gjerman, **GJKGje** gjithnjë e më shumë zbaton stilin diskursiv dialogjik ku peshon konsiderata të ndryshme kundrejt qëllimit që synohet.[163]

Diçka më e zakonshme duket gjendja me **GJKHu**, në veçanti sa i përket kontekstit të arsyetimit kushtetues dhe strukturës së tij argumentuese gjatë periudhës së artë të zhvillimit të saj. Në këtë periudhë (1990-1998), nën kryesinë e kryetarit të saj erudit ***László Sólyom***, ajo me një zell të madh i është qasur ndërtimit të infrastrukturës konceptuale të së drejtës së re kushtetuese hungareze, e cila në lëmin e gjyqësisë kushtetuese u cilësua si interpretim me qëllim të krijimit të një **kushtetute të padukshme**. Për këtë kemi folur më herët, bazuar në librin e arkitektit ideor të këtij koncepti, në të cilën diskutohet dhe përpunohet teoria dhe praktika e kushtetutës së padukshme.[164] Përmes metodës objektive teleologjike, që synon gjetjen e argumenteve harmonizuese përmes përdorimit të argumente substanciale, si p.sh. argumentet mbi sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe dinjitetin njerëzor, si dhe argumentet mbi "sistemin e caktuar të vlerave që thuhet se

[162] Michaela Hailbronner and Stefan Martini, "The German Federal Constitutional Court". Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 356-393 në fq. 367.

[163] Ibid., fq. 368-369.

[164] Idenë e **kushtetutës së padukshme (invisible constitution)**, si teori dhe si praktikë, përfshirë tërë aparatin konceptual të përdorur për ndërtimin konceptual të idesë së këtij lloji të konstitucionalizmit hungarez në vitet e para formative të **GJKHu**, e ka shtjelluar vetë ***László Sólyom*** *në veprën e tij Constitutional Judiciary in a New Democracy: The Hungarian Constitutional Court (University of Michigan Press: Michigan, 2000).*

qëndrojnë prapa neneve dhe parimeve kushtetuese*",*[165] **GJKHu** në vitet e para të punës së saj prodhoi vendime informative me fuqi bindëse prej precedenti për ata që do të vinin më pas. Nuk ndryshon asgjë në këtë mes fakti që, më vonë, gjenerata e dytë e gjyqtarëve ndryshoi qëndrimin lidhur me kushtetutën e padukshme, por as fakti që pas ardhjes së ***Viktor Orbán*** në pushtetet në vitin 2010, juridiksioni i **GJKHu** u reduktuara në mënyrë dramatike: përvoja kolosale e **GJKHu**, si një ndër gjykatat më aktiviste në botë, ngelet si një trashëgimi për vendet në tranzicion që duan të mësojnë mësime pozitive për rolin transformues të vendimeve të gjykatës kushtetuese të miratuara me ndërgjegje profesionale dhe kurajë qytetare. Për këtë periudhë të zhvillimit të **GJKHu** kemi bërë fjalë gjerësisht në vendet tjera.[166] Këtu nuk flasim më gjatë për këtë, sepse kemi ndërmend t'i kthehemi diskutimit mbi strukturat argumentuese të vendimeve të **GJKHu** gjatë kësaj periudhe.

Në literaturë është konstatuar se, në të shumtën e rasteve, struktura argumentuese e vendimeve të **GJKHu** për periudhën e saj formative është e stilit **zinxhiror linear**, pasuar nga stili këmbët e karriges. Gjatë kësaj periudhë nuk vërejtur se ka pasur ndonjë vendim me **strukturë dialoguese**, përveç në një rast.

Stili i dytë i strukturës argumentuese është përdorur vetëm për një lloj të vendimeve, përkatësisht vetëm për vendimet me të cilat janë shpallur jo kushtetues normat ligjore apo ligjet si tërësi. Në këto vendime, struktura argumentuese shprehet me fjalët, ta zëmë, se *"*… ligji është në kundërshtim jo vetëm me nenin …, por edhe me nenet … apo nenin … të Kushtetutës*"*. Për këtë përfundim radhiten zakonisht disa argumente ashtu që secili prej tyre në mënyrë të ndarë dhe të pavarur mund të anulojë ligjin apo normën/normat përkatëse të kontestuara. Pse **GJKHu** ka bërë këtë anulim masiv të normës/normave apo të ligjit të sfiduar? Arsyeja qëndron se në vitet e para formative ka pasur nevojë të përdoret retorika për ta bindur ligjvënësin dhe publikun për profesionalizmin dhe përkushtimin e saj ndaj Kushtetutës dhe konstitucionalizmit të ri hungarez në ndërtim e sipër.

Sa i përket rastit si më sipër që përbën një përjashtim, pra vendimi në **stilin dialogues** (ku secili argument veç e veç nuk çon në asnjë përfundim, përveç nëse merren në shqyrtim së bashku), i njëjti ka pasur të bëj me deklarimin e ekzistimit të së drejtës së përgjithshme për **liri personale**, e cila derivohet nga shumë të drejta dhe liri të tjera shprehimore kushtetuese, që, së bashku, formojnë thelbin e **lirisë personale**.[167] Ky rast ka pasur të bëjë me sfidimin nga një grup qytetarësh të një ligji për shëndetësi, në pjesën që ka pasur të bëjë me trajtimin e personave me aftësi të kufizuara mendore. Kërkuesit pretendonin se ligji në fjalë cenonte dispozitat kushtetuese mbi dinjitetin njerëzor, lirinë e pacientit me të meta mendore dhe, për pasojë, autonominë e tij personale. Pas shqyrtimit të rastit, GJKHu vendosi se ishte kundër parimit të autonomisë personale, e cila ankorohet në dinjitetin njerëzor (neni 54.1 i **Kushtetutës së Hungarisë**), çdo kufizim i të drejtës për dhënien e pëlqimit për shërbimet mjekësore dhe të drejtës për refuzim të shërbimeve të tilla në rastet kur bëhet fjalë për pacientë jokompetent (të paaftë për gjykim) apo kur kompetenca e pacientit është e kufizuar (me aftësi të kufizuara për gjykim). Përveç këtij argumenti, ajo tha se Parlamenti kishte krijuar, me nxjerrjen e këtij ligji, një situatë që është dështuese sa i përket rregullimit të kushteve ligjore për zbatimin e metodave dhe procedurave që kufizojnë në mënyrë të rreptë dhe të qartë të drejtën e lirisë pacientëve me gjykime të kufizuara apo me mungesë së tërësishme për të gjykuar. Për pasojë, nuk ekzistojnë garancione të mjaftueshme për të drejtën për të qenë i lirë nga trajtimi degradues dhe jonjerëzor të personave të tillë të cilëve u mungon liria.[168]

Në praktikën e **gjyqësisë kushtetuese irlandeze**, arsyetimi kushtetues, në vija të trasha, mbështetet në traditën e të **drejtës së përgjithshme**, përkundër ekzistimit të një kushtetute të shkruar. Cilësi themelore e këtij arsyetimi kushtetues është mosthënia në mënyrë shprehimore e të gjitha argumenteve të përdoruara për zgjidhjen e çështjes kushtetuese, si dhe mosthënia e argumenteve që mbështeten në përdorimin e precedenteve, me fokus të veçantë në identifikimin e aspekteve juridike të problemit. Kjo ndodh krahas praktikës së rrënjosur thellë të arsyetimit kushtetues në këtë vend, i cili bazohet apo frymëzohet nga teksti i **Kushtetutës së Irlandës** (1937), por që nuk kufizohet në interpretimin e saj literal. Sa i përket llojit të argumenteve, të gjitha janë prezente me përjashtim të

---

[165] András Jakab, Johanna Fröhlich, "The Constitutional Court of Hungary". Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 394-437 në fq. 399-400.

[166] Cf. më shumë në seksionin 5.2 të kapitullit pesë.

[167] András Jakab, Johanna Fröhlich, "The Constitutional Court of Hungary", fq. 407.

[168] **Judgement:** Case 36/2000 (X.27) AB. **Constitutional Court of Hungary**. Në internet:https://www.globalheal thrights.org/health-topics/health-care-and-health-services/decision-362000-x-27-ab/ (shikuar në qershor 2019).

argumentit që bazohet në federalizëm dhe në konceptit të bërthamës të së drejtave kushtetuese. Këto dy lloje të argumenteve, asnjëherë nuk janë përdorur në gjykimet kushtetuese në **Gjykatën Supreme të Irlandës** (**GJSIr**), e cila kryen funksionet e gjykatës kushtetuese në këtë vend.[169]

Lidhur me strukturën e argumentit kushtetues ekzistojnë dy periudha: periudha e vjetër, para vitit 1994, kur është vërejtur përdorimi i stilit të vendimeve me **strukturë argumentuese zinxhirore**; pas këtij viti, në mënyrë graduale ka gjetur zbatim dominant **struktura e argumenteve paralele**, në dy format e tyre (argumenti paralel konkluzive apo stili **këmbët e karriges** dhe argumenti jo-konkluziv në mënyrë individuale por vetëm kumulativisht apo **stili dialogues**). Një zhvendosje apo ndryshim si ky në stilin e vendimeve të **GJSIr**, në literaturë i atribuohet shumë faktorëve. Në rend të parë, kjo thuhet se ka të bëjë me rritjen e kompleksitetit të argumenteve të prezantuara nga palët në një kontest kushtetues, duke u pasuar nga argumentet që lidhen me përdorimin e shpeshtë të parashtresave me shkrim, ndërmarrjen e hulumtimeve të thella për rastet konkrete që presin zgjidhje dhe krijimin e mundësive të mëdha për qasje në burime dhe precedentë të huaj kushtetues.[170]

Në gjyqësinë kushtetuese të **Izraelit**, kjo nuk kështu, përkundër që ky vend ka qenë ish-koloni britanike dhe nën ndikimin e fortë të Britanisë së Madhe, njëjtë si Irlanda. **Gjykata Supreme e Izraelit** (**GJSIz**), deri në vitin 1992 ka prodhuar vendime të natyrës kushtetuese të arsyetuara kryesisht mbi bazën e tekstit ekzistues ligjor, pa parë në te ndonjë vlerë normative. Kjo nënkupton që, në dekadat e para formative të **Shtetit të Izraelit**, ka dominuar parimi i ndarjes së pushteteve, ku gjyqtarët kanë vetëm fuqi interpretuese të produkteve të **Knesset**-it (**Parlamenti i Izraelit**). Në këtë kuptim, ndikimi britanik i supremacisë (epërsisë) së ligjit, në këtë fazë, ka qenë dominant.[171]

Kjo gjendje ka ndryshuar në vitet 1992 dhe 1994 respektivisht. Në këto dy vite u nxorën dy ligje mbi të drejtat e njeriut,[172] të cilat përmes interpretimit të **GJSIz** në mënyrë graduale kanë fituar statusin e teksteve që përbëjnë norma me fuqi kushtetuese, përkatësisht me fuqi më të lartë normative se çdo normë tjetër ligjore. Kjo u cilësua si "**revolucion kushtetues**", cilësim që lidhet me një vendim dhe me një personalitet izraelit.[173] E kemi fjalën për vendimin në rastin **United Mizrahi Bank v. Migdal Cooperative Village** (1995)[174] dhe për ish-kryetarin e **Aharon Barak** të **GJSIZ.**[175] Që nga kjo kohë, **GJSIz** më nuk i sheh këto dy ligje si ligje të zakonshme por si ligje me status super-kushtetues, ani se vetë **Izraeli** sot e kësaj dite nuk ka një tekst kushtetues të kodifikuar në një dokument të vetëm. Përveç në aspektin e mospasjes së një kushtetute të shkruar, **Izraeli** dallon nga ish-metropola e vet, **Britania e Madhe**, sa i përket kontrollit kushtetues sepse ua njeh fuqinë normative ligjeve të **Knesset**-it.[176] Ky autorizim i dhënë domosdo që ka rezultuar në njohjen e një të drejte tjetër **GJSIz**, përkatësisht njohjen për të ushtruar kontrollin

---

169 Eoin Carolan, "The Supreme Court of Irland". Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 438-470 në fq. 449-453.

170 Ibid., fq. 452-453.

171 Suzie Navot, "The Israeli Supreme Court". Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq.471-515 në fq. 482.

172 **Israel: Basic Law of 1992, Human Dignity and Liberty**, 25 March 1992. Në internet : https:// www.refworld. org/docid/3ae6b52618.html (shikuar më19 qershor 2019); **Israel: Basic Law of 1994, Freedom of Occuptaion,** 9 March 1994. Në internet : http://www.servat.unibe.ch/icl/is11000_.html.

173 Cf. më shumë në Gideon Sapir, "Constitutional revolutions: Israel as a case-study" *International Journal of Law in Context*, Vol. 5 No. 4 (2009) fq. 355–378.

174 **United Mizrahi Bank v. Migdal Cooperative Village.** CA 6821/93. Decided November 1994. Për tekstin e plotë të aktgjykimit, shih në internet në këtë vegëz : http:// versa. cardozo. yu.edu/sites/ default/ files/upload/ opinions/ United %20 Mizrachi % 20Bank%20 v.%20Migdal%20Cooperative%20Village_0.pdf (shikuar më 20 qershor 2019).

175 Suzie Navot, "The Israeli Supreme Court", fq. 283; Lidhur me rolin e gjyqtarit më të lartë në vend, të gjyqtarit kushtetues, krahaso pikëpamjet e vetë autorit **Aharon Barak** në shkrimin e tij të gjatë "A Judge on Judging: The Role of a Supreme Court in a Democracy", botuar në *Harvard Law Review* Vol. 116 No. 16 (2002-2003) fq. 19-162 (në këtë shkrim, autori jep pikëpamjet e tij sipas së cilave gjyqësori duhet t'i përmbahet kushtetutës dhe ligjit, parimeve dhe vlerave të demokracisë kushtetuese, ku ndarja e pushteteve dhe gjyqësori i pavarur përbëjnë shtyllat kryesore; autori në mënyrë lakonike shprehet se gjyqtarët kushtetues kanë një "Ylli Polar" që i udhëheq në punët e tyre, i cili përbëhet nga vlerat fundamentale dhe parimet e demokracisë kushtetuese).

176 **Aharon Barak**, duke pasur parasysh kontekstin specifik izraelit, bën dallimin lakonik në mes të rolit të gjyqësorit si mbrojtës i demokracisë formale, që mishërohet në epërsinë (supremacinë) e vullnetit të parlamentit, dhe si mbrojtës i demokracisë substanciale, që mishërohet në vlerat bazike dhe të drejtat e njeriut. Cf. Aharon Barak, "A Judge on Judging: The Role of a Supreme Court in a Democracy", fq. 26.

kushtetues ndaj secilit produkt të **Knesset**-it me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së dy ligjeve si më sipër nga vitit 1992 dhe 1994. Këto dy autorizime, i pari për të t'ua njohur fuqinë kushtetuese dy ligjeve si më sipër dhe, i dyti, njohja e **GJSIz** si mekanizëm suprem për garantimin e fuqisë kushtetuese të këtyre dy ligjeve, kanë bërë që vetë interpretimi kushtetues dhe struktura e tij të marrin një stil të veçantë dhe të dallueshëm nga interpretimi i zakonshëm jo kushtetues dhe jonormativ që ushtrohet nga gjykatat izraelit (interpretimi i zakonshëm për qëllimet e zbatimit të thjeshtë të ligjit kundrejt fakteve të një rasti). E shprehur më qartë dhe me fjalë të tjera: që nga vendimi i rastit të vitit 1995, si më sipër, **GJSIz** ka ndërtuar të drejtën e vet për të ushtruar kontrollin kushtetues të ligjeve me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së disa normave ligjore kundrejt normave tjera që nuk gjenden në dy ligjet e sipërcekura të vitit 1992 dhe 1994 respektivisht. Ky ndryshim i ri, i nisur me vendimin e vitit 1995 të **GJSIz**, jashtë çdo dyshimi reflekton një ndikim të fuqishëm të **Gjykatës Supreme Amerikane (GJSAm)**, i filozofisë së saj të kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë që ka filluar me rastin famoz **Marbury vs. Madison** (1803).[177]

Arsyeja pse nga kjo kohë e tutje, përkatësisht që nga interpretimi kushtetues i vitit 1995 të ligjeve të viteve respektivisht 1992 dhe 1994 mbi të drejtat e njeriut, në **Izrael** dominon një strukturë tjetër argumentuese lidhet kryesisht me faktin se dy ligjet në fjalë kanë parime themelore dhe klauzola që definojnë qëllimin e nxjerrjes së tyre.[178] Para kësaj kohe, ligjet, sikundër u tha, shiheshin si objekte interpretimi ekskluzivisht për qëllimet e zbatimit konkret që përmbanin normat ligjore, jo për nxjerrjen dhe ndërtimin e parimeve që do të vlenin për të gjitha rastet tjera në të ardhmen.

Klauzola e përbashkët në këto dy ligje thekson si vijon:

"Liritë themelore në Izrael bazohen në njohjen e vlerës së qenies njerëzore, shenjtërinë e jetës së njeriut dhe në parimin se të gjithë njerëzit janë të lirë; këto të drejta do të mbrohen në frymën e parimeve të parashikuara në Deklaratën mbi Themelimin e Shtetit të Izraelit".[179]

Kjo klauzolë ka vënë themelet e parimeve kryesore udhëheqëse mbi të cilat duhet të mbështetet përvoja e interpretimit kushtetues me rastin e përcaktimit të caqeve të lirive dhe të drejtave të njeriut. Si e tillë, klauzola ka ndihmuar në formësimin e përmbajtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut në **Izrael**, jo vetëm të atyre që shprehimisht janë të parashikuara në këto dy ligje. Se kjo është kështu qartë zbulohet nga fakti i thjeshtë se, përveç klauzolës si më sipër, ligjet ngërthejnë në tekstin e tyre edhe qëllimin për të cilin janë nxjerrë: ai qëllim, thuhet përmes një formulimi të njëjtë që gjendet në këto dy ligje, ankorohet në ndërtimin e vlerave të **Shtetit të Izraelit** si shtet hebre dhe demokratik. Praktika gjyqësore izraelite, këtë rrethanë e ka sforcuar në veçanti në kontekst të interpretimit kushtetues të **Ligji Bazik: Dinjiteti i Njeriut dhe Liria**, ashtu që aktgjykimet e **GJSIz** të dhëna në kontekst të arsyetimeve kushtetuese për këtë ligj vejnë në dukje ekzistimin e disa të drejtave dhe lirive njerëzore që nuk janë të parashikuara (sanksionuara) shprehimisht në ligjin si më sipër e as në ligjet e tjera izraelite. Të drejta dhe liri të kësaj kategorie, sipas praktikës së **GJSIz** janë cilësuar si vijon: **liria e shprehjes, liria e fesë dhe e besimit dhe disa të drejta të ndryshme në procedurën penale, sikundër dhe disa aspekte të caktuara të së drejtës për barazi.** Njohja e statusit kushtetues të këtyre të drejtave ka ndikuar substancialisht në përmbajtjen e të drejtës kushtetuese në **Izrael**. Në literaturë, kjo është cilësuar si ndryshim i **Kushtetutës së Izraelit**, e cila, në fakt, siç u tha, nuk ekziston askund si një tekst i kodifikuar. Ky ndryshim, gjithnjë sipas literaturës, ka ndodhur përmes interpretimeve kushtetuese të natyrës si më sipër të bëra nga **GJSIz.**[180]

Sikundër u konstatua më lart, zhvillimet në gjyqësinë kushtetuese izraelite kanë pasur efekt edhe ndaj strukturës së argumentit kushtetues të prodhuar në vendimet e **GJSIz**. Në të shumtën e rasteve, Gjykata fillimisht paraqet parimet themelore të cilat shërbejnë si bazë për zgjidhjen e rastit konkret, parime që kryesisht derivohen nga vendimet e mëhershme (**stare decisis**) dhe zbatohen ndaj rastit konkret. Këto vendime kanë **strukturë zinxhirore lineare**, d.m.th. përdoren vetëm një argument konkluziv për vendosjen e rastit. Argumenti **këmbët e karriges**, përkatësisht

---

177 Për një trajtim të shkëlqyer të këtij konstatimi, cf. më shumë në Yoram Rabin Arnon Gutfel, "*Marbury v. Madison* and Its Impact on Israeli Constitutional Law". *University of Miami International and Comparative Law Review Vol*. 15 No. 2 (2014) fq. 303-335; Cf. po ashtu në Aharon Barak, "A Judge on Judging: The Role of a Supreme Court in a Democracy" fq. 27.

178 Suzie Navot, "The Israeli Supreme Court", fq. 483.

179 **Ligjit Bazik: Liria e Profesionit**, Seksioni 1; **Ligjit Bazik: Dinjiteti Njerëzor dhe Liria**, Seksioni 1.

180 Suzie Navot, "The Israeli Supreme Court", fq. 484.

përdorimi i më shumë argumenteve me fuqi të njëjtë të pavarur konkluzive për zgjidhjen e rastit përdoret shumë më pak. Në literaturë është shënuar se janë tepër të rralla rastet e vendimeve që përdorin **argumente dialoguese**, përkatësisht argumente që nuk janë përfundimtare në mënyrë autonome por vetëm nëse përdoren në mënyrë kumulative. I tillë është rasti **Eisenberg**, i cili ka pasur të bëjë me një ankesë kundër emërimit të një personi me të kaluar kriminale të vërtetuar me vendim gjyqi në pozitën e drejtorit të përgjithshëm në një ministri në **Izrael**. Në këtë rast, **GJSIz**, **inter alia**, arsyetoi për sa vijon:

"[..] Deri këtu janë shqyrtuar vetëm bazat juridike që kanë të bëjnë me detyrimin e Qeverisë për të marrë parasysh të kaluarën kriminale të personave me rastin e caktimit të tyre në detyra të shërbyesve civil... Mirëpo, me sa duket, një detyrim i tillë rrjedh nga burime të tjera juridike... [...]". [181]

Me këtë rast mbyllim diskutimin për **Izraelin** dhe strukturën e argumentit kushtetues në gjyqësinë kushtetues të këtij vendi, për të kaluar në përvojën italiane.

Stili i arsyetimit të vendimeve në **GJKIt** ndryshon në vartësi të llojit të vendimeve. Ky dallim shprehet si pasojë e akterëve të ndryshëm që paraqiten si palë të autorizuara, në veçanti kur bëhet fjalë për kontrollin kushtetues të kompetencave, që dukshëm dallon nga vendimet e dhëna në procedurat që kanë të bëjnë me kontrollin kushtetues të ligjvënies në Parlament. Vendimet që kanë formën e aktgjykimeve (**sentenze**) kanë dy pjesë: pjesa e parë, e titulluar "faktet e rastit", i dedikohet përmbledhjes së përmbajtjes së kërkesës (**petitum**-it) dhe argumentet e propozuara nga palët në parashtresat e tyre me shkrim; pjesa e dytë, e titulluar "përfundimet lidhur me anën juridike të rastit", fillon me disa paragrafë ku jepen kërkesat (**petitum**-et) e palëve me qëllim të qartësimit të **thema decidendum** (objektin e aktgjykimit apo të vendimmarrjes kushtetuese). Në këtë pjesë po ashtu gjenden paragrafët që përmbajnë arsyetimin e Gjykatës lidhur me **thema decidendum.**[182] Në fund pason verdikti (dispozitivi) i aktgjykimit. Fjala këtu është si për aktgjykimet meritore me efekt **erga omnes**, ashtu edhe për aktgjykimet që nuk e kanë këtë, të cilat janë diskutuar më sipër.[183]

Sa i përket strukturës argumentuese, vlen të theksohet se këtu nuk ekziston një strukturë dominante e argumentimi: në dekadat e para të jetës dhe punës, në punën e Gjykatës kanë dominuar vendimet me **stil zinxhiror të argumentimit**, i cili edhe sot akoma ekziston krahas strukturës argumentuese **këmbët e karriges** dhe **strukturës dialoguese**

---

[181] Nga formulimi si më sipër i **GJSIz**, duket qartë se asnjëra nga dy arsyet e dhëna, secila veç e veç, nuk mund ta mbështesin asnjë përfundim, përkatësisht se asnjëri prej tyre në vetvete dhe në mënyrë të pavarur nuk mund të shërbejë si bazë mbështetëse e verdiktit përfundimtar. Kjo është kështu ne veçanti nëse merret parasysh se në këtë rast **GJSIz** ka deklaruar në mënyrë shprehimore që ekziston një normë e re që vlen në mënyrë të njëjtë për të gjitha agjencitë qeveritare.
Ky rast është trajtuar disa herë në **GJSIz.** Në fillim, pas urdhrit të parë gjyqësor, qeveritarët kanë ndryshuar komisionin për emërim të kandidatit me të kaluar kriminale, **Yossi Ginossar**, mirëpo **Ministria e Ndërtimit dhe Banimit** (MNB) sërish ka insistuar në caktimin e kandidatit të njëjtë për drejtor. Kjo ka bërë që, më në fund**, GJSIz** të marr vendim për anulim të vendimit të **MNB** për caktim si drejtor të personit me të kaluar kriminale, **duke përdorur një arsyetim diskursiv dhe dialogues**: asnjëri prej argumenteve të përdorura, veç e veç dhe në mënyrë të pavarur, nuk mund të shërbej si bazë e pavarur argumentuese për verdiktin përfundimtar që anulon vendimin për caktim të personit me të kaluar kriminale për drejtor të përgjithshëm në **MNB**.
Me këtë rast, ne shkëputëm vetëm pjesën si më sipër për të parë esencën e argumentit dialogues me premisa të theksuara diskurseve, pra, fjalinë në të cilën argumenti vetëm flet e nuk thotë asgjë: vetëm kur lexohet në tërësi me fragmentet e tjera të tij, argumenti e jep kuptimin përfundimtar të verdiktit, përkatësisht vetëm atëherë kur të gjitha argumentet lexohen së bashku shpërfaqet arsyeja se përse është anuluar vendimi për caktimin e **Yossi Ginossar** si drejtor i përgjithshëm. Për tekstin e plotë të vendimit, cf. **Eisenberg v. Minister of Building and Housing**. HCJ 6163/92. Decided: March 23, 1993. Në internet: https://versa.cardozo.yu.edu/opinions /eisenberg-v-minister-building-and-housing; Për komentet e tij, Cf. më shumë në Yoav Dotan, "Judicial Review and Political Accountability: The Case of the High Court of Justice in Israel". *Israel Law Review* Volume 32, Issue 3 (Summer 1998) fq. 448-474 në fq. 465 fusn. nr. 51 dhe teksti që e shoqëron; Daphne Barak-Erez, "Judicial Review of Politics: The Israeli Case" *Journal of Law and Society* Vol. 29, No. 4 (Dec., 2002), pp. 611-631 në fq. 620-621 (ku autori diskuton problemin në fjalë për caktimit të personit me të kaluar kriminale në pozitën e drejtorit të përgjithshëm në kontekstin e nominimeve politike, mirëpo nxjerr përfundimin se ekzistojnë baza të ndryshme për anulim të vendimeve për emërime qeveritare, duke e futur rastin **Eisnberg** në kategorinë a anulimeve për shkak të shkeljeve ligjore që lidhen me të kaluarën e kandidatit; ekzistimi I shumë arsyeve për anulim e bënë konfuz argumentin kushtetues, kur asnjë argument i vetëm nuk mund të çoj në verdiktin anulues); Gal Dor and Menachem Hofnung, "Litigation as Political Participation". *Israel Studies* Vol. 11, No. 2 (Summer, 2006), fq 131-157 në fq. 139; Suzie Navot, "The Israeli Supreme Court", fq. 485.

[182] Tania Groppi and Irene Spigno, "The Constitrutional Court of Italy". Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 516-559 në fq. 528-529.

[183] Cf. 15.2.2.1 dhe 15.2.2.3 **supra**, në këtë kapitull.

(në këtë të fundit, asnjë argument në mënyrë të pavarur nuk çon në një përfundim por vetëm nëse lexohen dhe kuptohen si një tërësi e marrë së bashku).[184]

Në literaturë janë dhënë disa arsye pse aktualisht ka pak përfaqësim të **strukturës zinxhirore argumentuese** në gjyqësinë kushtetuese italiane. Si arsye e parë përmendet mungesa e mendimeve mospajtuese dhe çfarëdo lloj mendimi tjetër i ndarë, gjë që bën të rritet kolegjialiteti ndërmjet gjyqtarëve dhe çdoherë të synohet nxjerrja e vendimit që reflekton gjithëpërfshirje të mendimeve të trupës së gjyqtarëve kushtetues marrë si tërësi. Hulumtimet, për më tepër, tregojnë se nganjëherë shtyhet marrja e vendimit deri sa të arrihet një konsensus maksimal në mes të anëtarëve të trupës gjyqësore. Shih për këtë, i saktë del mendimi që thotë se vendimet me **strukturë argumentuese zinxhirore**, të pakta në numër, merren me konsensus të plotë, në ndërkohë që tjerat, ato që kanë strukturë **këmbët e karriges** ose **strukturë dialoguese**, merren me më një konsensus shumë të ulët të trupës gjyqësore. E thënë me fjalë të tjera, vendimet që kanë konsensus janë vendime me **strukturë zinxhirore** kurse ato që nuk reflektojnë konsensus të ulët kanë strukturë argumentuese **këmbët e karriges** ose **strukturë argumentuese dialoguese.**[185]

Si arsye e dytë, në vijim si më sipër, që shpjegon mungesën e **strukturës argumentuese zinxhirore** në mesin e vendimmarrjes së **GJKIt** përmendet shumësia e argumenteve të parashtruara nga ana e palëve: kur palët janë prezente më shumë argumente, preferohet vendimmarrja më shumë argumente, qoftë në formën e strukturës argumentuese **këmbët e karriges** ose me **strukturën argumentuese dialoguese**. Kjo nënkupton se Gjykata në këto raste, kur palët prezantojnë më shumë argumente në favor të provimit të themeltësisë së kërkesës e tyre, domosdo detyrohet të përdorë strukturën argumentuese më të strukturuar sepse duhet dhënë përgjigje në çdo argument të kërkesës së iniciuar nga palët.[186]

Së fundi, personaliteti individual i gjyqtarëve që përpilojnë vendimet përfundimtare në emër të Gjykatës përmenden si arsye që përcakton stilin e argumentimit. Në këtë kontekst, zakonisht veçohen personalitetet e gjyqtarëve që vijnë nga jeta akademike: në këto raste, gjyqtarët që kanë sfond akademik universitar, kanë prirje për të shkruar më gjatë dhe në mënyrë më të qartë, më të artikuluar dhe me një elokuencë.[187]

Në përvojën e gjatë të gjyqësisë kushtetuese italiane, në të vërtetë, njerëz nga bota akademike kanë qenë në shumicë. Kjo rrethanë, nëse merret parasysh së bashku me dy arsyet si më sipër, përbën shkaktarin kryesor për dominim të **strukturave argumentuese jo-zinxhirore**: nisur nga fakti se asnjëherë nuk ka pasur mirëkuptim për futjen e mendimeve mospajtuese dhe të mendimeve konkurruese, si dhe fakti që në të shumtën e rasteve palët, jo personat e tretë (sepse ata nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në procedurë), paraqesin argumente të shumta me shkrim, Gjykatës nuk i ngelet zgjidhje tjetër për të ruajtur legjitimitetin e vet brenda dhe jashtë sallës së gjykimit pos të marrë vendime që prodhojnë struktura të komplikuara argumentuese. Këto struktura janë dominuese, si kur bëhet fjalë për vendimet me strukturë këmbët e karriges ashtu edhe për ato me strukturë dialoguese dhe diskursive. Vetëm nëse merren parasysh tre faktorët si më sipër (mungesa e mendimeve mospajtuese e konkurruese, dominimi i gjyqtarëve me origjinë nga bota akademike dhe prodhimi i argumenteve të shumta nga palët, si pasojë e mungesës së prezencës së palëve të treta në procedurat pranë **GJKIt**), atëherë mund të kuptohen si duhet arsyet për dominim të strukturave jo-zinxhirore të argumentimit në gjyqësinë kushtetuese italiane.[188]

---

184 Tania Groppi and Irene Spigno, "The Constitrutional Court of Italy", fq. 529.

185 Ibid., fq. 529

186 Ibid., fq. 529

187 Ibid., fq. 529

188 Për mungesën e mendimeve mospajtuese si dhe për mungesën e autorizimit të palëve të treta për të marrë pjesë në gjykimet kushtetuese, cf. më shumë në Giancarlo Rolla & Tani Groppi, "Between Politics and the Law: The Development of Constitutional Review in Italy". Në Sadurski, Wojciech (ed.), *Constitutional Justice, East and West,* fq.143-159 në fq. 156 (autori thekson përpjekjet e vazhdueshme në teori dhe praktikë për të përmirësuar këtë gjendje, por pa ndonjë sukses të prekjshëm); Për dominimin e gjyqtarëve me origjinë nga bota akademike, Cf. më shumë në Patrizia Pederzoli, "I GIUDICI DELLA CORTE COSTITUZIONALE " *dis CRIMEN articoli*, 23.11.2018. Në internet: https://discrimen.it/wp-content/uploads/Pederzoli-I-giudici-della-Corte-costituzio n ale.pdf (shikuar më 21 qershor 2019) (autorja në fund të shkrimit, në tabelën nr. 3, jep pasqyrën e detajuar, me të gjitha të dhënat personale dhe të tjera që kanë të bëjnë me origjinën e gjyqtarëve kushtetues, që nga përbërja e parë e **TKIt** në vitin 1955).

Në frymën e traditës **evropiane/kelseniane** të gjyqësisë kushtetuese, **Spanja** përmes **TKSp** manifeston dy cilësi të përbashkëta me këtë traditë: e para, vendimet e saj në vitet e para formative, njëjtë si në **Kosovë** dhe gjetiu nëpër **Evropë**, përshkohen nga shtjellimet doktrinare dhe me fuqi të theksuar precedenciale (thuajse në çdo pikë të realizimit kompetencave të veta juridiksionale); dhe, e dyta, struktura dominuese argumentuese është **zinxhirore me një argument konkluziv**, gjë që akomodon botëkuptimin tradicional evropian (dhe kosovar) që aktgjykimin e sheh si një produkt të silogjizmit gjyqësor, ku konkluzioni del natyrshëm dhe logjikshëm nga procesi i nënvënies (**subsumcionit**), përkatësisht nga barazimi i dy premisave. Ky proces përfshinë ndërmarrjen e disa hapave esencial paraprak me qëllim të përcaktimit të premisave: së pari saktësohet dhe identifikohet në mënyrë precize çështja që shtrohet për gjykim dhe vendosje, që njihet si premisa e poshtme (**premisa minor**) dhe, së dyti, saktësohet dhe identifikohet në mënyrë precize ligji apo dispozita juridike relevante që duhet të zbatohet në rastin konkret, që njihet si premsia e sipërme (**premisa major**). Në këtë proces, zgjidhja me fuqi juridike apo konkluzioni juridik rrjedh krejt në mënyrë të natyrshme dhe të dukshme. Kjo është kështu në veçanti kur bëhet fjalë për aktgjykimet në fushën e kontrollit kushtetues të vendimeve të autoriteteve publike që kanë për objekt vendosjen mbi liritë dhe të drejtat kushtetuese, mirëpo gjen zbatim edhe në fushën e kontrollit kushtetues të ligjeve dhe të akteve të tjera juridike, si dhe në rastet e vendimmarrjes lidhur me konfliktin për kompetencë.[189]

Sa i përket dy llojeve të tjera të strukturave argumentuese, vlen të theksohet se ato janë shumë më të rralla në këtë vend. Në literaturë, një gjë e tillë arsyetohet me faktin që aktgjykimi kushtetues është i njëjtë sikurse aktgjykimi në praktikën e gjyqësorit të rregullt, përkatësisht se në dy juridiksionet (atë kushtetues dhe në gjyqësorin e rregullt) bëhet fjalë për një proces arsyetimi që është krejt teknik dhe koherent, proces në të cilin preferencat subjektive dhe arbitrare nuk mund të gjejnë vend. Kjo përbën arsyen kryesore të dominimit të **strukturës argumentuese zinxhirore**: kjo d.m.th. se dy premisat si më sipër barazohen ndërmjet veti përmes operacionit silogjistik me qëllim që të arrihet deri të përfundimi juridik i zgjidhjes së rastit, disi në mënyrë automatike.

Sa i përket strukturës argumentuese **këmbët e karriges** dhe strukturës argumentuese **dialoguese**, në praktikën e **TKSp** kanë një përfaqësim shumë të rrallë dhe zakonisht vihen në punë në ato raste ku nuk ka një konsensus të mjaftueshëm shoqëror, përkatësisht në rastet që polarizojnë opinionin publik, siç është çështja e abortit,[190] e **ideologjive nëpër shkolla**,[191] e **martesës ndërmjet sekseve të njëjta** (deri në ligjësimin e saj në vitin 2005)[192] etj. etj. Një vend tjetër ku gjejnë zbatim këto dy struktura argumentuese janë rastet që vështirë se mund të durojnë

---

189 Marian Ahumada Ruiz, "The Spanish Constitutional Court". Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 604-640 në fq. 619-620.

190 **Constitutional Court Judgment No. 53/1985**, of April 11 1985. **Constitutional Tribunal of Spain** (Unofficial translation). Në internet: https://www.tribunalconstitucional.es/ResolucionesTraducidas/53-1985,%20of%20 April %2011.pdf (shikuar më 25 qershor 2019) (ky aktgjykim ka bërë dekriminalizimin e pjesshëm të abortit dhe ka strukturë argumentuese **këmbët e karriges**, i shprehur në 7 paragrafe dhe me një mendim mospajtues).

191 Cf. **Constitutional Court Judgment No. 5/1981**, of February 13. **Constitutional Tribunal of Spain** (Unofficial translation). Në internet: https://www.tribunalconstitucional.es/ResolucionesTraducidas/5-1981,%20of%20Februar y%2013.pdf (në 30 faqe dhe 28 paragrafë me strukturë argumentuese **këmbët e karriges**, **TKSp** anulon disa dispozita ligjore që kanë të bëjnë me kontrollin ideologjik nëpër shkolla publike dhe dallimin në mes të shkollave publike dhe shkollave të tjera private); Cf. edhe **Sentencia del Tribunal Constitucional** 51/2011 në rastin **Moore v President of the Methodist Conference,** botuar në Oxford Journal of Law and Religion Vol. 1 Issue 1 (2012) fq. 296 (cenimi lirisë ideologjike nga neni 16 i **Kushteutës së Spanjës** së vitit 1978); Për komentet doktrinare të kësaj teme, përfshirë aspektet historike dhe aktuale të rolit dhe pozitës së religjionit dhe laicitetit në Spanjë, Cf. më shumë në Zoila Combalia & Maria Roca, "Religion and the Secular State of Spain". Në Javier Martínez-Torrón and W. Cole Durham, Jr. (eds.), *Religion and the Secular State: Interim National Reports Issued for the Occasion of the XVIIIth International Congress of Comparative Law* (The International Center for Law and Religion Studies: USA, July 2010) fq. 640-642 (ku autori në mënyrë specifike diskuton vendimet e mësipërme të **TKSp** lidhur me neutralitetin ideologjik dhe fetar nëpër shkollat publike apo në shkollat priva\te që financohen me fonde publike).

192 Për herë të parë, martesa në mes të sekseve të njëjta u lejua me një ligj të vitit 2005, i cili u sfidua në **TKSp** nga partitë konservative. Në nëntor të vitit 2012, **TKSp** vendosi në favor të kushtetutshmërisë së ligjit dhe çështja u mbyll, mirëpo jo edhe debati në publik. Për historinë e përligjësimit dhe debatet e mospajtimet e thella lidhur me këtë temë deri në vendimin e **TKSp** të 6 nëntori 2012, Cf. më shumë në punimin e shkëlqyer Carlos Martínez de Aguirre, "Same-sex marriage in Spanish law" *PRAWO W DZIAŁANIU SPRAWY CYWILNE* Tom 25 SPIS T**REŚCI** (2016) fq. 206-217; Për tekstin e plotë të aktgjykimit të datës 6 nëntor 2012, i cili ka strukturë argumentuese **këmbët e karriges**, në 18 faqe dhe 11 paragrafë, Cf. **Constitutional Court Judgment** No. 198/2012 of November 6 (Unofficial translation). Në internet: https://www.tribunalconstitucional.es/ResolucionesTraducidas/ 198-2012%20 of% 20Nov ember %2 06 pdf.

ndërtimin e teorive të reja, për shkak të specifikave të tyre që nuk mundësojnë gjeneralizime të vendimmarrjeve apo të precedentëve nga e kaluara, siç është rasti, ta zëmë, me marrëdhënien ndërmjet kushtetutave nacionale dhe kushtetutshmërisë evropiane në sferën mbrojtjes më të fortë të lirive dhe të drejtave njerëzore[193] apo me natyrën dhe funksionin kushtetues të **statuteve të komuniteteve autonome** që ekzistojnë në **Spanjë** etj.[194]

Gjykata Kushtetuese e Tajvanit (**GJKTajv**) paraqet një rast mjaft interesant në aspektin e stilit të shkrimit të argumenteve dhe strukturës së tyre. Në literaturën hulumtuese është vërejtur se dominon **struktura argumentuese me zinxhirore me një resht**, e pasuar nga vendimet që kanë **strukturë argumentuese dialoguese** dhe **strukturë argumentuese këmbët e karriges**. Rasti i mendimeve dominuese haset edhe në vendimet që kanë për objekt vendosjen e rasteve të komplikuara dhe mjaft të rënda, siç kanë qenë rastet që lidhen me krizën kushtetuese (vazhdimi mandateve të qeverisë aktuale për kohë të gjatë, pas marrjes së pushtetit nga ana e komunistëve kinez në **Kinën** kontinentale) apo me depërtimin e të huajve pa dëgjim gjyqësor. Ky dominim i këtyre strukturave argumentuese, në esencë, përbën një përjashtim sepse zakonisht **strukturat argumentuese zinxhirore me një rresht** i takojnë vendimeve që nuk janë të ndërlikuara dhe shumë të gjata. Në rastin tajvanez, e vërteta është vetëm sa i përket vëllimit të vendimeve: zakonisht vendimet e **GJKTajv** janë të shkurtra dhe me strukturë argumentuese zinxhirore me një rresht.[195]

Vendimi i parë me **strukturë dialoguese** (argumentet paralele nuk janë përfundimtare nëse lexohen veç e veç, përkatësisht që janë përfundimtare vetëm nëse lexohen së bashku) është nxjerrë në vitin 1989 dhe ka pasur të bëjë me vlerësimin e kushtetutshmërisë së martesës së dytë që lejohej në **Kodin Civil të Tajvanit**. Në këtë rast, Gjykata e njohu si kushtetuese **martesën e dytë** me arsyetim se lufta dhe largimi shumëvjeçar i atyre që kishin ikur në **Tajvan** pas marrjes së pushtetit në Kinën kontinentale nga

---

193 Marian Ahumada Ruiz, "The Spanish Constitutional Court". Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 622; Për rastin e mbrojtjes në disa nivele të lirive dhe të drejtave të njeriut (niveli nacional i garancionave kushtetuese dhe niveli evropian që parashikohet me **Kartën e të Drejtave Fundamentale në Unionin Evropian** të vitit 2000), si dhe për problemet tjera në mes të konstitucionalizmit nacional dhe atij evropian, cf. më shumë në (ku autori flet për natyrën e përbërë të konstitucionalizmit evropian, si diçka që ka natyrë të shkriftë dhe që mund të ofroj një nivel tjetër të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave fundamentale të qytetarëve të vendeve të **Unionit Evropian**, në ndërkohë që për të njëjtat liri apo të drejta njerëzore mund të ketë një ofertë më efektive dhe më të mirë të mbrojtjes së tyre në nivel nacional të vendeve anëtare; si shkas për këtë merret rasti i njohur si "**arrest warrant**", që në **Evropë** ka testuar shumë themelet e konstitutcionailimit të Unionit dhe të vetë shteteve anëtare në luftën e tyre kundër terrorizmit ndërkombëtar; ai testim ka pasur dhe ka të bëjë me ruajtjen e parametrave të sundimit të ligjit dhe të lirive e të drejtave njerëzore që kanë të bëjnë me gjykimin e drejtë dhe të paanshëm në luftën kundër terrorizmit në të gjitha fazat e zhvillimit të kësaj luftë); Po ashtu, Cf. edhe historikun e konstitutcionalizmit evropian pas dështimit të miratimit të kushtetutës dhe para saj, në Allan Rosas and Lorna Armati, *EU Constitutional Law. An Introduction* (Hart Publishing: Oxford and Portland, Oregon: 2018).

194 Enrique Guillén López, "Judicial Review in Spain: The Constitutional Court". *Loyola of Los Angeles Law Reviews* Vol. 41 No. 2 (Winter 2008) fq. 529-562 në fq. 543 – 545 & 550-554 (autori tregon se në **Spanjë** ekzistojnë 17 regjione autonome dhe dy qytete me status autonom; regjionet dhe komunitetet autonome kanë statutet e tyre që kanë një lloj natyre juridike të marrëveshjeve individuale të secilit prej regjioneve dhe komuniteteve autonome të lidhura me qeverinë qendrore dhe së bashku formojnë **Spanjën** si një shtet; statutet e regjioneve autonome shërbejnë si parametra për vlerësimin e kushtetutshmërisë së veprimeve të autoriteteve lokale dhe janë versioni spanjoll i "**bloc de constitutionalite**", term ky i futur në **Spanjë** përmes ndikimit të juristit të njohur francez **Louis Favoreu**; arsyeja pse këto shërbejnë si pika referimi për **TKSp** është se **Kushtetuta e Spanjës** e vitit 1978 përmbanë vetëm parime dhe procedurat, të njohura si **principo dispositivo**, kurse statutet kanë dispozitat që kanë karakter regjional në mënyrë specifike dhe për të cilat dispozita nuk ka pasur konsensus që të futen në tekstin e Kushtetutës; për këtë arsye, pas nxjerrjes së statuteve të para në vitin 1979, menjëherë me kalimin e kohës ka nisur modernizimi i tyre, ku **TKSp** ka luajtur një rol të rëndësishëm për ruajtjen e parametrave të tyre kushtetues dhe të vetë tërësisë territoriale e unitetit të vendit, thekson autori); James Casey, "The Spanish Constitutional Court" *The Irish Jurist* Vol. 25/27 (1990/1992), fq. 26-56 (ku autori vjen deri të konkluzioni se **TKSp** në lëmin e ruajtjes së autonomive spanjolle ka pasur një rekord shumë pozitiv; autori thekson se statutet e autonomive regjionale kanë statusin e instrumenteve kushtetuese); Cf. Po ashtu edhe një vendim mbi pesëdhjetë faqe të **TKSp** lidhur me kontrollin kushtetues të **Ligjit Organik 62006** të datës 19 korrik 2006 mbi amendamentimin e **Statutit të Katalonisë**, ku janë shpallur si pa efekt juridik dispozitat e këtij Ligji që flasin për **Kataloninë** si komb, dhe për realitetin nacional në **Kataloni;** përveç kësaj, ky vendim shpall si jo-kushtetues një sër dispozitash konkrete të ligjit në fjalë; ky vendi, që ka formën e aktgjykimit, përbëhet nga dy pjesë të mëdha të mbarëshruara në 147 paragrafë: pjesa e parë paraqet përmbledhjen e rastit dhe pikëpamjet e palëve rreth rastit dhe **thema decidendum**, kurse e ngërthen argumentimin e **TKSp**, për të kaluar në fund të verdikti dhe dispozitivi; argumentimi ka strukturë dialoguese diskursive që për qëllim ka të sqaroj lexuesin për historinë e autonomisë së **Katalonisë**, faktin që **Statuti i Katalonisë** nuk mund të jetë ushtrim i të drejtës sovrane por i të drejtës së bartur, se çdo aktivitet normavënës në Kataloni duhet t'i nënshtrohet **Kushtetutës së Spanjës** dhe kështu me radhë. **Constitutional Court Judgment No. 31/2010**, of June 28 (Unofficial translation). **Constitutional Tribunal of Spain.** Në internet: https://www.tribunalconstitucional.es/ResolucionesTraducidas/31-2010,%20of%20June%2028.pdf (shikuar në 26 qershor 2019).

195 Wen – Chen Chang, "The Constitutional Court of Taivan". Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 641-678 në fq. 650-651.

komunistët, kishin rezultuar në ndarjen fizike të bashkëshortëve. Kjo rrethanë e bënte situatën e emigrantëve shumë të jashtëzakonshme dhe specifike, por edhe të përkohshme si gjeneratë në të njëjtën kohë.[196] Një rast tjetër me rëndësi që ka pasur strukturën e njëjtë argumentuese dialoguese i takon kohës së më vonshme dhe është zgjidhur në vitin 2002. Ai ka pasur të bëj me **sigurimin shëndetësor nacional**: çështja kushtetuese këtu ka qenë nëse pushteti lokal do të duhej të paguante për **sigurimin shëndetësor nacional**. Lidhur me këtë, Gjykata tha se kjo përbënte një detyrim kushtetues të autoriteteve vendore. Të njëjtat autoritete, megjithatë, gëzonin të drejtën kushtetuese për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe menaxhim të sigurimit shëndetësor nacional për aq sa kjo ka të bëjë me ruajtjen e buxhetit, financave dhe autoritetit financiar të pushtetit lokal.[197]

Si raste më të rëndësishme të vendimeve me strukturë argumentuese **këmbët e karriges** janë rasti i pozitës së të akuzuarit në procedurë penale.[198] rasti i hetimit të një incidenti me armë në zgjedhjet presidenciale[199] dhe, në fund, rasti i karantinës së detyrueshme ligjore gjatë kohës së sëmundjeve epidemike.[200] Në tri këto raste, **GJKTajv** ka nxjerrë vendime me arsyetime që përmbajnë argumente konkluzive individuale, përkatësisht ku secili nga argumentet e përdorura çon në anulimin e ligjit përkatësisht në gjetjen si jo kushtetues të produktit të parlamentit ose të ndonjë veprimi tjetër të autoriteteve shtetërore apo të autoriteteve të tjera publike.

Në praktikën gjyqësore të **Gjykatës Supreme të Mbretërisë së Bashkuar** (**GJSMB**) nuk bëhet dallim në mes të çështjeve kushtetuese dhe çështjeve të zakonshme juridike: dyja zgjidhen (vendosen) me të njëjtin vendim.[201] Ky dallim ka rëndësi të vihet në dukje për qëllimet e shtjellimeve tona të strukturës argumentuese të vendimeve të **GJSMB**. Kjo sepse mund të ndodhë që vendimi për çështjen kushtetuese të ketë **strukturë argumentuese zinxhirore** (me një argument linear të prodhuar përmes **silogjizmit gjyqësor** të zakonshëm), kurse verdikti (pjesa e vendimit) që ka të bëj me çështjen juridike të mbështetet në argumente të tjera shtesë, duke prodhuar kështu në fund një vendim me **strukturë të përzier argumentuese** ku **struktura zinxhirore e argumentimit** ka vetëm një argument linear, kurse pjesa tjetër e vendimit që ka të bëjë me çështjen jo kushtetuese mbështetet në disa argumente që kanë strukturën **këmbët e karriges**. Kjo nënkupton se sa i përket çështjes kushtetuese nuk mund të ketë vendim me **strukturë argumentuese dialoguese/diskursive** (disa argumente që vetëm së bashku mund të çojnë në një përfundim sepse nëse përdorën ndaras dhe në mënyrë të pavarur nuk thonë asgjë për problemin, duke mos çuar në asnjë drejtim zgjidhjen e tij). Për të ndodhur kjo, pra, për të pasur vendim me **strukturë argumentuese dialoguese/diskursvie**, që në fillim duhet që vendimi mbi çështjen kushtetuese të dominojë si tërësi verdiktin përfundimtar, gjë që në praktikë ndodh shumë rrallë. Për këtë arsye, në Britani dominon **struktura zinxhirore lineare me një argument**, në ndërkohë që dy strukturat tjera paraqiten vetëm atëherë kur gjyqtarët kanë nevojë për vendime të ndërmjetëm gjatë vendosjes së çështjeve kushtetuese.[202]

---

196 Ibid., fq. 651-652.

197 Ibid., fq. 652.

198 Ky rast ka pasur të bëjë me vlerësimin e kushtetutshmërisë së një praktike që lëndonte pozitën kushtetuese të të akuzuarit në procedurën penale: **GJKTajv** tha se praktika që ndalonte pyetjen kryqzatore të të akuzuarit- dëshmitar nga i akuzuari tjetër përbënte një precedent jo-kushtetues (në këtë rast **GJKTajv** ka vlerësuar kushtetutshmërinë e precedentit, jo të një ligji taivanez). Ibid. fq. 652.

199 Ky rast ka pasur të bëjë me një ligj që lejonte formimin e një komisioni hetimor për të hetuar kushtetutshmërinë e formimit të një komisioni hetimor nga ana e ligjvënësit tajvanez për të hetuar rastin e gjuajtjes me armë në zgjedhjet presidenciale: **GJKTajv** tha se ligjvënësi kishte të drejtë për një gjë të tillë, por nuk mund të pengonte ekzekutivin e **Taivanit** që edhe ai të formonte një komision të tillë hetimor sepse ky i fundit kishte të drejtë të natyrshme për një gjë të tillë. Ibid., fq. 652-653.

200 Ky rast ka pasur me ligjin për karantinë, kur **GJKTajv** gjeti se ligji ishte jo-kushtetues për shkak se shkelte lirinë fizike dhe qartësinë e sigurinë juridike në të njëjtën kohë. Ibid., fq. 653.

201 Tamas Gyorfi, "The Supreme Court (The House of Lords) of the United Kingdom". Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 679-722 në fq. 692.

202 Ibid., fq. 693.

Nga kjo gjendje si më sipër ekzistojnë dy përjashtime. Ato kanë të bëjnë me vendimet e dhëna në lëmin e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut. Sikundër dihet, në **Britani të Madhe** ekziston një traditë e lashtë e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut, që nis me **Magna Carta** (1215). Bazuar në këtë burim të së drejtës, në gjyqësorin britanik është ndërtuar tradita e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave njerëzore në **të drejtën e përgjithshme**. Kjo, thënë me fjalë tjera, shërben si baza e parë dhe më e vjetër juridike e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut. Me miratimin e **Ligjit për të Drejtat e Njeriut** në vitin 1988 (**Human Rights Act**) është krijuar edhe një tjetër bazë juridike për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, krahas të **drejtës së përgjithshme**, tani bazuar në tekstin e shkruar të këtij ligji. Për këtë arsye, gjyqtarët duhet, në rastet e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut, të zhvillojnë argumente paralele (qoftë të natyrës **këmbët e karriges** apo të natyrës **dialoguese/ diskursive**).

Në vijim, si më sipër, përjashtimi i dytë më shumë lidhet me fazat e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut përmes rrugës gjyqësore. Në fazën e parë, gjyqtarët përcaktojnë nëse ka pasur ndërhyrje në liritë dhe të drejtat individuale nga ana e shtetit apo autoriteteve të tjera publike. Nëse përgjigja në këtë pyetje është afirmative, atëherë nis faza e dytë në të cilën gjyqtarët vlerësojnë nëse pushteti shtetëror apo publik ka qenë i arsyeshëm në ndërhyrjen dhe kufizimin e lirive dhe të drejtave njerëzore.

Për arsyet si më sipër, gjyqtarët mund të zhvillojnë llojet të nduarnduarshme të strukturave argumentuese: mund të ndodhë që gjyqtarët me një argument të vetëm konstatojnë se ka pasur ndërhyrje të pa arsyeshme nga ana e shtetit apo autoriteteve të tjera publike, por edhe mund të theksojnë se ekziston ndërhyrja në fjalë, duke zhvilluar në të njëjtën kohë **argumente me strukturë paralele** me të cilat arsyetohet ndërhyrja e tillë shtetërore/publike për shkak të ekzistimit të një interesi madhor, për shkak se ndërhyrja është proporcionale me qëllimin që synohet të arrihet, për shkak se ndërhyrja nuk prish substancën e të drejtës apo lirisë së mbrojtur, për shkak se një gjë e tillë ka qenë me kohë e përcaktuar qartë me ligj dhe kështu me radhë. Këto arsye në kontekstin kosovar numërohen në nenin 55 të Kushtetutës së vitit 2008.[203] Vendimet me **strukturë dialoguese/diskurseve** janë jashtëzakonisht të rralla në këto raste.[204]

Në praktikën gjyqësore të **SHBA**-ve, me pikë referimi në rend të parë **GJSAm**, strukturën argumentuese duhet kërkuar në natyrën e arsyetimit të vendimeve gjyqësore: për dallim nga **Britania e Madhe**, që bazohet në epërsinë (supremacinë) e Parlamentit, në **SHBA** arsyetimi i argumenteve ndjek standardin legalistik, i cili haset nëpër arsyetimet e vendimeve të gjyqësorit të rregullt amerikan. Kjo është kështu si rezultat i ekzistimit të juridiksionit dual: sipas nenit III (2) të **Kushtetutës së SHBA**-ve, **GJSAm** ka juridiksion mbi çështjet dhe mosmarrëveshjet e natyrës jo kushtetuese dhe kushtetuese në të njëjtën kohë, të natyrës publike apo private. E thënë me fjalë tjera, arsyetimi legalistik vlen si për vendimet mbi çështjet jo kushtetuese ashtu edhe në ato për

---

[203] Neni 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] i Kushtetutës:
"1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.
2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.
3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.
4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.
5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrsesi esencën e së drejtës së garantuar."

[204] Në literaturë është vërejtur se vetëm tri raste që kanë pasur natyrë dialoguese në këto vitet e fundit. Në të gjitha raste, megjithatë, fjala ka qenë për vendime të ndërmjetme, të cilat janë marrë në vijim të zgjidhjes së çështjes kryesore, e cila, në anën tjetër, në vendimin përfundimtar ka strukturë argumentuese zinxhirore me një argument. Cf. Tamas Gyorfi, "The Supreme Court (The House of Lords) of the United Kingdom". Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 694.

çështjet kushtetuese: prezenca e arsyetimit legalistik në argumentimin kushtetues përbën një cilësi të veçantë të konstitucionalizmit amerikan.[205] Veç tekstit të Kushtetutë dokumentet tjera nuk kanë cilësi të burimeve të së drejtës kushtetuese, përkundër përpjekjeve për të futur edhe **Deklaratën e Pavarësisë** në këtë kategori.[206]

Kjo qasje legalistike ndaj argumentit kushtetues dikton edhe strukturën e tij: në të shumtën e rasteve dominon argumenti me **strukturë arsyetuese zinxhirore** (zbatimi i një rreshti arsyetues për të lëvizur nga një parim në tjetrin më qëllim të arritjes në konkluzionin përfundimtar).[207] Sikundër kemi theksuar disa herë, ky lloj argumentimi i shkon për shtati dhe është produkt i pashmangshëm i vënies në jetë të **teknikës legalistike** të arsyetimit të argumenteve kushtetuese, përkatësisht është produkt i sologjizmit të zakonshëm gjyqësor në të cilin nuk është parësore vërtetimi (konfirmimi) i tekstit të Kushtetutës, por zgjidhja e rastet dhe mosmarrëveshjes në tërësinë e saj. Në sistemin **kelsenian/evropian**, sikundër dihet, parësore është vërtetimi (konstatimi) i cenimit apo jo të dispozitave konkrete kushtetuese, në ndërkohë që në **SHBA** supremacia (epërsia) e Kushtetutës sigurohet (arrihet) përmes ndërtimit të parimeve dhe standardeve kushtetuese krahas zgjidhjes apo vendosjes lidhur me rastin apo mosmarrëveshjes konkrete. Kjo nënkupton që një liri apo e drejtë konkrete rreth së cilës ka lindur rasti apo mosmarrëveshja mund të mos e shoh dritën (mund të humbet rasti), në një kohë që Gjykata vazhdon me ndërtimin e parimeve dhe standardeve kushtetuese të zbatueshme për të ardhmen, që kanë fuqi detyruese **erga omnes** si pasojë e efekteve të doktrinës **stare decisis**. E thënë me fjalë të tjera, çështja që ka të bëj me liritë dhe të drejtat e njeriut dhe që ka qenë objekt fillestar dhe vetë shkaku i procedurave, në ndërkohë që Gjykata vazhdon me elaborimin e rastit dhe mosmarrëveshjes me qëllim të ndërtimit të standardeve dhe parime kushtetuese, të cilat kanë fuqi detyruese **erga omnes** si pasojë e zbatimit të doktrinës **stare decisis**. Kjo praktikë ka nisur me rastin **Marbury vs. Madison**, në të cilin Gjykata ka mohuar se ekzistonte e drejta për mjet juridik për paditësin (Marbury), duke ndërtuar në të njëjtën kohë standardin mbi supremacinë (epërsisë) e **Kushtetutës Amerikane**, i cili duhet të sigurohet, që nga ajo kohë, përmes pushtetit gjyqësor dhe shtjellimit legalistik të argumenteve.

Me përvojën amerikane e mbyllim pjesën krahasuese të nisur më sipër në këtë seksion dhe i kthehemi praktikës gjyqësore në Kosovë. Si është gjendja me përvojën kosovare në fushën e strukturimit të argumenteve kushtetuese?

Pjesa në vijim bën fjalë për përvojën modeste kosovare në sferën e argumentit kushtetues, llojet dhe strukturën e tij. Temat e trajtuara në seksionet pararendëse paraqesin një risi me të cilën **Gjykata Kushtetuese** nuk është ballafaquar deri më sot, ose është ballafaquar por në një masë shumë të butë (rasti **Pacolli** dhe rasti i **Asociacionit**, për të cilat folëm më sipër).[208] Nga përvoja e sipërcekur e gjykatave të huaja, gjyqësia kushtetuese në Kosovë mund të përfitojë mjaft. Këtij qëllimi i shërbejnë rreshtat në vijim, të cilët ekspozojnë studiuesin dhe gjyqtarin kushtetues kosovar me përvojat e huaja në argumentimin kushtetues, strukturën dhe llojin e tij, gjithnjë me qëllim dhe shpresë së ky seksion do të ngre vetëdijen për analizë të thuktë të strukturës dhe llojit të argumentimit kushtetuese sipas përvojës së vendeve të tjera. Nuk është serioze ajo gjyqësi kushtetuese që nuk merr parasysh të drejtën kushtetuese krahasimore dhe gjyqësinë e saj kushtetuese. Kjo vlen si për aspektin material, dhe mbi të gjitha vlen për këtë aspekt, ashtu edhe sa i përket aspekteve të tjera procedurale lidhur me jetën dhe punën e gjyqësisë kushtetuese.

---

[205] Howard Schweber and Jennifer L. Brookhart, "The Supreme Court of the United States". Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 723-760 në fq. 734.

[206] Ibid., fq. 734.

[207] Rastet e strukturave argumentuese **këmbët e karriges** dhe **strukturave dialoguese/diskursive** janë shumë të rralla, kurse ndër argumentet më të përdorura janë format e ndryshme të asaj që atje cilësohet si origjinalizëm. Ky argument ka së paku tri forma: **origjinalizmi subjektiv** (ashtu siç e kanë kuptuar tekstin e **Kushtetutës Amerikane** ata që e kanë shkruar); **origjinalizmi objektiv** (ashtu siç e kanë kuptuar tekstin e **Kushtetutës Amerikane** në opinionin publik) dhe, së fundi, **origjinalizmi legal** (ashtu siç e kanë kuptuar tekstin e **Kushtetutës Amerikane** ata që e kanë ratifikuar). Cf. Ibid., fq. 736-737.

[208] Cf. seksionet 15.1, 15.3 & 15.2.2.1, **supra**, dhe komentet tona atje.

Në fillet e para të punës së saj, **Gjykata Kushtetuese** ka prodhuar vendime mjaft të shkurtra. Kjo ka qenë pasojë imediate e gjendjes emergjente dhe i kushteve të punës: Gjykata ka nisur punën e saj e vetmuar dhe pa asnjë staf apo teknikë pune. Vendimet e para të saj janë shkruar në gjuhën shqipe dhe janë përkthyer nga vetë gjyqtarët në dy gjuhët tjera (serbisht dhe anglisht). Pas një viti, Gjykata ka kompletuar shumicën e stafit të saj administrativ dhe teknik ashtu që kushtet për punë janë përmirësuar dukshëm, gjë që u reflektua edhe në vendimet e saj, të cilat, nga viti 2010 e tutje, qartë duken më të strukturuara dhe më të gjata se ato të fillimit të punës së saj. Një ndër arsyet për këtë ndryshim është edhe prezenca e gjyqtarëve ndërkombëtar dhe e këshilltarëve ligjor ndërkombëtar.[209] Në veçanti këta të fundit kanë qenë të vyeshëm, shumë profesional. Ata kanë shërbyer si përpilues dhe redaktues të pjesës dërrmuese të vendimeve të Gjykatës.

Të gjitha vendimet e **Gjykatës Kushtetuese,** sa i përket strukturës argumentuese, mund të ndahen në dy grupe të mëdha: në grupin e parë hyjnë vendimet që kanë **strukturë zinxhirore** me një argument ("**one line single conclusive argument**"), kurse në të dytin janë vendimet **këmbët e karriges**, me shumë argumente konkluzive që mund të përdoren në mënyrë të pavarur ("**chain of arguments, mutually conclusive arguments**"). Nga analiza e rasteve të Gjykatës del se të grupit të parë janë kryesisht **aktvendimet për papranueshmëri** në rastet e kërkesave individuale (kërkesat që mbajnë shenjën dalluese **KI**). Kjo vlen, **mutatis mutandis**, edhe sa i përket aktgjykimeve (vendimet meritore) në rastet e kërkesave individuale. Te këto vendime argumenti është zinxhiror, i njëjtë sa i përket ndikimit në verdiktin përfundimtar. Kjo është kështu sepse në vendimet lidhur me kërkesat individuale për bazë kryesore referimi dhe për parametër kryesor kushtetues Gjykata ka jurisprudencën e **Gjykatës së Strasburgut** dhe arsyetimet e saj të dhëna me rastin e interpretimit të **KEDNJ**.

Në grupin e dytë, ndërkaq, në shumicën e rasteve hyjnë vendimet meritore (aktgjykimet) e Gjykatës që japin përgjigje për kërkesat e palëve dhe mbajnë shenjën dalluese **KO**. Në këto raste, argumentet janë të shumta dhe të ndryshme, mirëpo secila prej tyre në mënyrë autonome çon në përfundim të njëjtë sipas mënyrës së njëjtë, ani se mund të jenë argumente të ndryshme. Këtu nuk është esenca te fakti që argumentet janë të ndryshme por te ajo se ato provojnë fakte të njëjta dhe çojnë në përfundim të njëjtë. Në rastet me shenjën dalluese **KO** shumë rrallë kërkesa është e papranueshme : edhe atëherë kur ekziston një rast i tillë, struktura e argumentit është e njëjtë - **këmbët e karriges**, me shumë argumente konkluzive që mund të përdoren në mënyrë të pavarur ("**chain of argments, mutually conclusive arguments**"). Të tilla janë argumentet për shkak të natyrës komplekse të rasteve që mbajnë shenjën **KO** (që kanë për palë personat juridik dhe institucionet e vendit), në veçanti kur bëhet fjalë për kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së normës. Kjo është kështu sepse lloji i argumentit që përdoret ka për bazë jo vetëm tekstin kushtetues, por edhe llojet tjera të argumenteve nga gjyqësia kushtetuese krahasimore. E thënë me fjalë të tjera, lloji i argumentit që shërben si parametër kushtetues, është shumë kompleks dhe i nduarnduarshëm dhe nuk mund të gjendet vetëm në tekstin e Kushtetutës së vitit 2008: argumenti gjendet në kushtetutat e huaja të vendeve demokratike, në përvojat e vendeve anëtare të **Komisionit të Venecias** dhe në vetë mendimet e dokumentet e këtij Komisioni dhe kështu me radhë.

15.4. Zbatimi i vendimeve të gjykatave kushtetuese

Zbatimi i vendimeve të gjykatave kushtetuese, segmenti i tretë i detyrimit të përgjithshëm (**erga omnes**) që buron nga vendimet e nxjerra nga këto gjykata, ndryshon nga një vend në tjetrin. **Kosova** nuk bën përjashtim në këtë drejtim. Ekzekutimi i vendimeve të gjykatave kushtetuese përbën aktin përfundimtar, kurorëzues i interpretimit kushtetutës me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së normave kushtetuese. Kur bëhet fjalë për vendimet e dhëna në rastet individuale (sipas ankesës kushtetuese), ekzekutimi përfaqëson njërën ndër komponentet kryesore, pjesën përbërëse të së drejtës për gjykim të drejtë

[209] Steven Hill & Paul Linden-Retek, "Supervised Independence and Post-Conflict Sovereignty: The Dynamics of Hybridity in Kosovo's New Constitutional Court". *The Yale Journal of International Law Online* Vol. 36 No. 38 (Fall 2010), fq.26-43 në fq. 40 fusnota nr. 71. Në internet: https://cpb-us-w2.wpmucdn.com/campuspress.yale.edu/ dist/8/ 15 81/files/2017/01/0-36-hill-linden-retek-hybridity-in-kosovo-1tnty08.pdf (shikuar në prill 2018).

dhe të paanshëm. Ky është një standard i etabluar i **Gjykatës së Strasburgut.**[210] Vonesat në ekzekutim të vendimeve mund të ndodhin për arsye shumë të rënda, si p.sh., vështirësitë financiare të përkohshme në të cilat gjendet shteti apo rrethanat e tjera të përkohshme të jashtëzakonshme. Vonesat e tilla, megjithatë, asnjëherë nuk guxojnë të cenojnë substancën e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.[211]

Kushtetuat janë ato që urdhërojnë fuqi superiore (sipërore) të vendimeve të gjykatave kushtetuese. Ky urdhër që çon sipër dhe ngre në majë të të gjitha fuqive juridike ekzistuese vetëm vendimet e një organi kushtetues, të gjykatës kushtetuese, provon dy gjëra: *e parë*, se gjykatat kushtetuese nuk janë sikur gjykatat e zakonshme, për të cilat kushtetutat nuk kanë nevojë të theksojnë se vendimet e tyre kanë një fuqi përkatëse detyruese, duke e lënë këtë çështje në tërësi në kompetencën ligjore; dhe, *e dyta*, se gjykatat kushtetuese nuk janë as si organet tjera kushtetuese. Nëse nuk janë si gjyqësori i rregullt dhe as si organet tjera kushtetuese, kjo nënkupton se ato janë trupa suprem kushtetues, tërësisht të pavarura nga organet tjera kushtetuese, gjë që diktohet nga juridiksioni i gjykatave kushtetuese për kontrollin e kushtetutshmërisë së akteve, veprimeve dhe mosveprimeve të të gjitha organeve tjera kushtetuese. Kjo fuqi superiore, e urdhëruar nga kushtetutat nacionale, në rastin e Kosovës gjenden e sanksionuar në nenin 116.1 të Kushtetutës. Vetë fakti që në Kushtetutë përcaktohet kjo cilësi e vendimeve të gjykatave kushtetuese, duke i bërë ato, në parim, të vetekzekutueshme, diçka që nuk thuhet për vendimet e organeve të tjera, qartë tregon se gjyqësia kushtetuese përbën një aktivitet shtetëror superior që rrjedhë si pasojë e faktit se objekt i këtij aktiviteti shtetëror është sigurimi dhe mbajtja e supremacisë (epërsisë) së normave, parimeve dhe vlerave kushtetuese.

Në përvojën e shteteve të ndryshme, përfshirë **Kosovën**, në përgjithësi mund të thuhet se ekzistojnë dy rrugë apo dy zgjidhje sa i përket ekzekutimit të vendimeve të gjykatave kushtetuese:[212]

- rruga apo zgjidhja e parë, që është më e rrallë, është ajo ku ekzekutimi i vendimeve të gjykatave kushtetuese bëhet përmes sigurimit dhe ofrimit të garancioneve nga njëri prej organeve kryesore kushtetuese. Ai organ mund të jetë ekzekutivi nacional, si p.sh. rasti i **Shqipërisë**[213] dhe **Kroacisë**[214] apo shefi i shtetit dhe gjyqësori i rregullt, si p.sh. rasti **Austrisë,**[215] dhe
- rruga apo zgjidhja e dytë, që është dominante, është ajo ku vendimet e gjykatës kushtetuese janë të vetekzekutueshme, pra ato vetekzekutohen dhe nuk ekziston një garantues që siguron ekzekutimin e tyre. Në këtë rast, është vetë gjykata nacionale kushtetuese ajo që përcakton modalitetet e zbatimit apo ekzekutimit të vendimit të saj, të cilën zakonisht e kryejnë pa ndonjë vështirësi organet apo subjektet të cilët kanë detyrim kushtetues për një gjë të tillë, përfshirë këtu individët privat. Kjo qasje bazohet në supozimin se organet shtetërore dhe subjektet e së drejtës,

---

210 **AFFAIRE HORNSBY c. GRÈCE CASE OF HORNSBY v. GREECE** (ARTICLE 50) (107/1995/613/701) **ARRÊT/ JUDGMENT** Strasbourg. 1 er avril/ 1 April 1998. Në internet: https://www.legal-tools.Org/doc/e 571e8/pdf/ (shikuar më 6 korrik 2019).

211 **CASE OF BURDOV v. RUSSIA.** *(Application no. 59498/00).* **JUDGMENT**. Strasbourg. 7 May 2002. Në internet: http://sutyajnik.ru/rus/echr/judgments/burdov.htm (shikuar më 6 korrik 2019).

212 Duke iu referuar rastit të **Sllovakisë,** në literaturë është ndërtuar edhe rruga apo lloji i tretë: sipas kësaj qasje, gjykata kushtetuese fare nuk ka asnjë rol, as sipas kushtetutës dhe as sipas praktikës, në ekzekutimin e vendimeve të saj. Cf. Anahit Manasyan, "Execution of the Constitutional Court Decisions as a Guarantee for Strengthening the Constitutionalism (Example of the Republic of Armenia)". *Juridiskā zinātne / Law* (Journal of the University of Latvia) No. 8 (2015), fq. 190-197, në fq. 193 (fusnota nr. 6, ku autori citon autorët sllovak dhe doktrinën e tyre lidhur me këtë, si dhe dispozitat konkrete kushtetuese dhe ligiore lidhur me këtë çështje).

213 Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, neni 81.2 ["Ekzekutimi i vendimeve"]. Në internet: http://www. gjk.gov.al/web/ligj_ per_ organizimin_ dhe_ funksionimin e_ gjykates_kushtetuese_2016_1667. pdf, shikuar më 6 korrik 2019).

214 Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kroacisë, neni 31.3 ["Procedurat pranë Gjykatës Kushtetuese: Dispozitat e Përgjithshme"]. Në internet: https://www.usud.hr/sites/default/files/ dokumenti /The _ ConstitutionalAct_on_the_Constitutional_Court_of_the_Republic_of_Croatia_consolidated_text_Official_Gazette_No_49-02.pdf.

215 Kushtetuta e Austrisë e vitit 1920, në fuqi me ndryshimet dhe plotësimet e mëpastajme, nenet 145 dhe 146 ["Gjykata Kushtetuese"]. Në internet: http://constitutionnet.org/sites/default/files/Austria%20_FULL_%20Constit ution.pdf (shikuar më 8 korrik 2019).

> përfshirë individët, çdoherë veprojnë në mënyrë të përgjegjshme dhe në pajtim me kompetencat e tyre kushtetuese dhe ligjore, kurse gjykatat kushtetuese ndërhyjnë vetëm në rastet kur kjo është e domosdoshme. Thënë më fjalë të tjera, kjo qasje reflekton vetë idenë dhe themelet e shtetit të së drejtës ku të gjithë me vullnet zbatojnë kushtetutën si dhe vendimet e gjykatës kushtetuese që interpretojnë atë.[216]

Si në rastin e parë, ashtu dhe në të dytin, baza juridike e ekzekutimit duhet të kërkohet në tekstin e kushtetutës nacionale me të cilën specifikohet statusi juridik i vendimeve të gjykatës kushtetuese. Ai status është i një niveli superior (sipëror) kundrejt çdo vendimi apo akti tjetër individual, gjë që bën që vendimet në fjalë të kenë fuqi të përgjithshme detyruese, **erga omnes**, për krejt ambientin përreth (përveç autorit të produktit, përkatësisht përveç vetë gjykatës kushtetuese që ka nxjerrë vendimin, të cilin mund ta ndryshojë në çdo kohë sipas procedurave të parashikuara për vendimmarrje).

Si pasojë e kësaj fuqie juridike të vendimeve të gjykatës kushtetuese, e cila garantohet me kushtetutë, ligjet mbi gjykatat kushtetuese dhe aktet e tjera të brendshme normojnë materien e ekzekutimit. E thënë me fjalë të tjera, zakonisht janë kushtetutat ato që përcaktojnë vetëm statusin, përkatësisht vetëm fuqinë e përgjithshme detyruese, **erga omnes**, të vendimeve të gjykatave kushtetuese. Kjo është krejtësisht e natyrshme sepse vendimet e tilla interpretojnë kushtetutën dhe, për pasojë, sigurojnë supremacinë (epërsinë) e saj kundrejt çdo akti tjetër juridik në vend. Ndërkaq, janë ligjet për gjykatat kushtetuese ato që bëjnë operacionalizimin e mënyrës së ekzekutimit të vendimeve.

Këtë rrethanë nuk e gjejmë të normuar kur bëhet fjalë për vendimet e gjyqësorit të rregullt. Kjo është kështu sepse ekzekutimi i tyre bëhet nga organet dhe agjensionet shtetërore dhe autoritetet tjera publike, apo private (sipas autorizimit ligjor të mbështetur në kushtetutë). Në fakt, nuk shtrohet çështja e diskutimit të ekzekutimit të vendimeve të gjyqësorit të rregullt sepse ajo përbën një objekt normimi të detajuar ligjor në të gjitha dimensionet e tij (administrativ, civil dhe penal).

Sikundër u tha, janë ligjet mbi gjykatat kushtetuese ato që, zakonisht, përcaktojnë mënyrën e ekzekutimit dhe adresantin e vendimeve të gjykatës kushtetuese. Në rastet shumë të rralla, siç është, ta zëmë, **Bosnje-Hercegovina**, ***Çekia*** dhe **Kosova**, rregullat e brendshme të procedurës përcaktojnë një gjë të tillë. Po ashtu, në një ekstrem tjetër, të rralla janë rastet kur autoriteti që ekzekuton vendimet e gjykatës kushtetuese përcaktohet me kushtetutën nacionale. Nuk është problem kur kushtetuta përcakton autoritetin ekzekutues të vendimeve të gjykatës kushtetuese: një situatë e tillë paraqitet si krejt e natyrshme marrë parasysh faktin që kushtetutat përcaktojnë edhe statusin e vendimeve të gjykatave kushtetuese në kuadër të hierarkisë së akteve juridike nacionale. Një gjë e tillë përbën problem në vete atëherë kur ekzekutimin e normojnë rregullat e brendshme mbi organizimin e brendshëm dhe procedurën e gjykatës kushtetuese. Kjo është kështu për shkak se fuqia juridike e rregullave të brendshme nuk është e njëjtë me fuqinë juridike të normave kushtetuese dhe ligjore. Në veçanti kjo del si e saktë nëse kihet parasysh se këtu behet fjalë për saktësimin dhe përcaktimin e adresantit, si dhe të vetë mënyrës së ekzekutimit të vendimeve që interpretojnë kushtetutën nacionale me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së saj kundrejt çdo akti tjetër juridik, përfshirë këtu rregullat e brendshme të procedurës që normojnë jetën dhe punën e gjykatave kushtetuese, rregulla që, zakonisht, nxirren nga vetë gjykatat kushtetuese. E thënë me shkurt dhe me fjalë të tjera, normimi i adresantit dhe mënyrës së ekzekutimit me norma të brendshme të gjykatave kushtetuese nuk përbën një zgjidhje që ofron siguri të

---

[216] Në **gjyqësinë kushtetuese gjermane**, kur bëhet fjalë për këtë supozim sa i përket institucioneve dhe organeve kushtetuese është farkëtuar termi **luajalitet institucional**. Në këtë term përfshihet supozimi sipas të cilit të gjitha organet dhe institucionet kushtetuese duhet të kenë një qasje luajale ndaj kushtetutës dhe vendimeve të gjykatës kushtetuese me të cilat interpretohet kushtetuta e vendit dhe të kultivojnë respekt të ndërsjellë institucional. Cf. Siegfried Bross, "Reflections on the Execution of Constitutional Court Decisions in a Democratic State under the Rule of Law on the Basis of the Constitutional Law Situation in the Federal Republic of Germany" (Report). Në European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Conference on "Execution of the Decisions of Constitutional Cou`rts: A Cornerstone of the Process of Implementation of Constitutional Justice" on the Occasion of the 10th Anniversary of the Constitutional Court of Azarbaijan,* Baku, Azerbaijan 14-15 July 2008. CDL-JU(2009)001. Strasbourg, 27 January 2009. Engl. only Para. 2 në fq. 3. Në internet: https://www.venice.coe.int/webforms/documents /default.aspx?pdffi le=CDL-JU(2009)001-e (shikuar më 1 korrik 2019).

duhur juridike sepse të njëjtat mund të ndryshojnë në çdo kohë nga vetë autori i tyre.

Formulimi ligjor është i atillë që, sipas rregullit, vetë gjykatës kushtetuese i jepet autorizimi ligjor për të përcaktuar adresantin (autoritetin që duhet të kryejë ekzekutimin) dhe mënyrën e ekzekutimit të vendimeve të saj. Këtu çdoherë bëhet fjalë për vendimet meritore sepse vendimet tjera kanë efekte të kufizuara juridike ashtu që, zakonisht, edhe nuk shtrohet çështja e ekzekutimit të tyre. Krahas këtij autorizimi, ligjet për gjykatat kushtetuese specifikojnë edhe pasojat juridike që prodhohen nga vendimi i gjykatës kushtetuese.[217]

Në rastin e **Kosovës**, dispozitat kushtetuese të nenit 116.1 të Kushtetutës, të cekura më sipër, flasin për fuqinë e përgjithshme detyruese, **erga omnes**, të vendimeve, në ndërkohë që **Ligji Nr. 03/L-21** për Gjykatën Kushtetuese (**Ligji Nr. 03/L-21**) normon efektet juridike konkrete, veç e veç, që prodhohen nga vendimet e Gjykatës Kushtetuese, në vartësi të llojit të procedurës në të cilën jepen ato. E kemi fjalën për kreun e tretë të tij që rregullon procedurat e veçanta. **Rregullorja e Punës** (**RP**), ndërkaq, në mënyrë të detajuar normon çështjen e mënyrës së ekzekutimit të vendimeve të **Gjykatës Kushtetuese** dhe vetë adresantët e tyre.

Në vijim si më sipër, në Kosovë Gjykata mund të specifikoj në vendimin e saj mënyrën[218] dhe afatin kohor[219]për ekzekutim të vendimit të saj, sqarohet në dispozitën e rregullit 66. 4 ["Zbatimi i Vendimeve"] të **RP**. Organi që duhet të zbatoj vendimin është i paracaktuar nga fakti i origjinës së aktit juridik apo veprimit tjetër që është objekt i kontrollit kushtetues: ai çdoherë është autoritet shtetëror ose autoritet tjetër publik, gjë që nënkupton se objekt kontrolli kushtetues nuk mund të jenë veprimet apo veprimet e mosveprimet e autoriteteve që nuk kanë cilësi shtetërore përkatësisht publike. Organi i obliguar për të zbatuar vendimin e Gjykatës do të dorëzojë informatat, sipas kërkesës së shprehur në vendim të saj, dhe ashtu siç kërkohet me te, lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e tij.[220]

Këtu shtrohet çështja e përcjelljes së ekzekutimit të vendimit të Gjykatës: cili organ e bën një gjë të tillë? Laikët mund të mendojnë për një autoritet të jashtëm si për organin që bën mbikëqyrjen e ekzekutimeve të **Gjykatës Kushtetuese**. Kjo, megjithatë, nuk është kështu: sipas nenit 66.8 ["Zbatimi i Vendimeve"] të **RP**, Sekretariati, nën mbikëqyrjen e gjyqtarit, i cili në pajtim me rregullin 58 të **RP** e ka hartuar vendimin, do ta përcjellë zbatimin e vendimit, si dhe, sipas nevojës, do t'i raportojë Gjykatës lidhur me rekomandimin për procedurat e mëtejmë ligjore që duhet të ndërmerren. Në fillim të shtatorit të vitit 2012, me propozimin e kryetarit të parë të Gjykatës Kushtetuese, u pat formuar një komitet **ad hoc** që ka pasur për qëllim përcjelljen e ekzekutimit të vendimeve të saj. Ky komitet është përbërë nga kryetari i Gjykatës, një gjyqtar, tre këshilltar ligjor dhe Sekretari i Sekretariatit të Gjykatës.

---

217 Cf., lidhur me këtë, ta zëmë, ligjet si vijon: *Ligji Nr. 8577, datë 10 shkurt 2000 mbi Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*, nenet 76-81(ndryshuar me ligjin nr.99/2016). Në internet: http://www.gjk.gov.al/web/ligj_ per_organizimin_dhe_funksionimin_e_g jykates_ kushtetuese_ 2016_ 1667.pdf, shikuar më 6 korrik 2019); *Ligj*i *CLI i Hungarisë i vitit 2011 mbi Gjykatën Kushtetuese*, nenet 39 46. Në internet: https://www.refëorld.org/docid/4c345b5b2.html, shikuar më 6 korrik 2019); *Ligji mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës Federale të Gjermanisë i vitit 1951*, nenet 31, 35, 78-79 & 95. Në internet: http://www.bundesverfassungsgericht.de/Shared Docs/Doënloads/EN/Gesetze/BVerfGG.pdf?blob=publication File &v=6, shikuar më 6 korrik 2019); *Ligji mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Latvisë*, nenet 31-32 Në internet: http://www.satv.tiesa.gov.lv/en/, shikuar më 6 korrik 2019.

218 Kështu, ta zëmë, në rastet e njohura si **rastet e KEK-ut** ("Korporata Energjetike e Kosovës"), ku me një vendim pilot Gjykata gjeti se kishte pasur cenim të së drejtës kushtetuese për gjykim të drejtë dhe të paanshëm nga neni 31 i Kushtetutës, duke e rikthyer çështjen te Gjykata Supreme për rivendosje në pajtim gjetjet e shprehura në aktgjykimet e **Gjykatës Kushtetuese**. Ky lloj formulimi ripërsëritet çdoherë në aktgjykimet e Gjykatës të dhëna në procedurat sipas ankesës kushtetuese. Cf. *Rasti KI 40/09. Aktgjykim. Imer Ibrahimi dhe 48 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) kundër 49 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 23 qershor 2010. Nr. ref.: AGJ 30/10 (ky aktgjykim ka qenë pilot, i pari në mesin e mbi gjashtëdhjetë aktgjykimeve të dhëna lidhur me këtë rast)

219 Kështu, ta zëmë, në rastin e **Logos së Prizrenit**, rasti KO 01/09, Gjykata kërkoi nga Komuna e Prizrenit që të ndryshonte Statutin e saj, të ndryshonte emblemën e Komunës, duke mos përjashtuar nga tërë ky proces komunitetet e kësaj komune. Të gjitha këto veprime, sipas urdhrit të Gjykatës, duhej të ndërmerren brenda afatit tre mujor, i cili u shty edhe për tre muaj të tjerë, për çka Komuna ishte e detyruar që rregullisht t'i raportonte Gjykatës për gjendjen e gjërave. Cf. *Rasti KO 01/09. Aktgjykim. Qemajl Kurtishi dhe Kuvendi Komunal i Prizrenit.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtine, datë: 18 mars 2010. Ref. Nr. AGJ 07/10. Paragrafi 57.5.

220 Rregulli 66.5 ["Zbatimi i Vendimeve"] i **RP.**

Në pjesën dërrmuese të rasteve, vendimet e Gjykatës janë ekzekutuar nga subjektet të cilave u ka takuar me Kushtetutë e ligj vënia në jetë e urdhrave të përmbajtur në to. Në rast të moszbatimit të një vendimi, ose të vonesës në dhënien e informacioneve për Gjykatën për masat e ndërmarra, Gjykata mund të lëshojë një aktvendim në të cilin do të theksohet që vendimi nuk është zbatuar. Ky aktvendim publikohet në **Gazetën Zyrtare**.[221] Për këtë informohet Prokurori i Shtetit, thuhet në fjalinë e fundit të dispozitës së rregullit 66.8 të **RP.**[222] Çështja mbyllet me kaq dhe përtej kësaj Gjykata nuk ka asnjë mundësi tjetër në sferën e ekzekutimit të vendimeve të saj. Si qëndron, atëherë, çështja e përgjegjësisë penale dhe tjetër, për moszbatim të vendimeve të gjykatave kushtetuese?

Në përgjithësi, përgjegjësia penale për mosekzekutim të vendimeve të gjykatave kushtetuese është e rrallë: për shkak të natyrës së funksionit dhe të vetë fizionomisë së gjyqësisë kushtetuese nuk përqafohet si zgjidhje apo rrugë. I tillë është rasti me **Shqipërinë**.[223] Një vend tjetër që vlen të përmendet në këtë drejtim është edhe **Federata Ruse**: sipas kushtetutës, ligjit dhe legjislacionit penal në këtë vend, ekziston një zinxhir i organeve që kujdesen për ekzekutimin e vendimeve të **Gjykatës Kushtetuese të Federatës Ruse** (**GJKFR**), ndër të cilat hyn edhe prokurori i shtetit që kujdeset për nisjen e procedurave penale për mos-zbatim, mirëpo vetëm pas vërejtjes paraprake që e merr personi i ngarkuar me ekzekutim të vendimit. U mor vesh, këtu përjashtohen organet kushtetuese kur ato janë adresant të ekzekutimit të vendimeve: këto organe nuk mund të vishen me përgjegjësi penale, por vetëm me përgjegjësi kushtetuese. Kjo përgjegjësi konsiston në shkurtimin e afatit kushtetues apo në tërheqjen e kompetencave të dhëna kushtetuese në rastet kur organet e tilla veprojnë në kundërshtim me detyrimin që kanë për ekzekutim të vendimeve të **GJKFR.**[224]

Nuk përjashtohet mundësia që gjykatat kushtetuese mund të shqiptojnë edhe gjoba për moszbatim të vendimeve të saj, nisur nga fakti se ka rastet kur gjykatat kushtetuese kanë në juridiksionin e saj caktimin e dëmeve materiale apo vendosjen lidhur me kompensimet në të holla. I tillë është rasti, ta zëmë, me **GJKAu**.[225] Në Kosovë ky nuk është rasti: përtej publikimit të aktvendimit për moszbatim të vendimit të **Gjykatës Kushtetuese**, i cili ka formën e aktgjykimit (sepse e thamë që çdoherë çështja e ekzekutimit shtrohet lidhur me vendimet meritore) dhe informimit të Prokurorit të Shtetit për një gjë të tillë, Gjykata nuk ka asnjë fuqi tjetër ekzekutive. Në gjashtë vitet e para të punës ka pasur vetëm një rast kur Gjykata ka qenë e detyruar të shpall në **Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës** aktvendimin e saj me të cilin konstaton moszbatimin e vendimit të vet dhe, për pasojë, cenimin e mëtutjeshëm të të drejtave kushtetuese të individëve të afektuar me mosekzekutim.[226] Fjalën e kemi për "**rastin e Ferizajt**".[227]

---

221 Rregulli 66.8 ["Zbatimi i Vendimeve"] i **RP**.

222 Rregulli 66.8 ["Zbatimi i Vendimeve"] i **RP**.

223 Neni 81.4 ["Ekzekutimi i vendimeve"] të Ligji Nr. 8577, datë 10.2.2000 (ndryshuar me ligjin nr.99/2016) mbi Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë:
"[...] 4. Moszbatimi ose pengimi i ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese dënohet sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal."

224 Cf. më shumë për këtë në shkrimin elokuent të A. Chun'kov, "Supervision of the Execution of Decisions of the Constitutional Court of the Russian Federation." *Statutes & Decisions* Vol. 41 No. 2 (March – April 2005) fq. 47-52.

225 Kushtetuta e Austrisë e vitit 1920, në fuqi me ndryshimet dhe plotësimet e mëpastajme, neni 137 ["D. Gjykata Kushtetuese"].

226 Në kohën e shkrimit të këtyre rreshtave, korrik 2019, ekziston një refuzim total i **Komunës së Deçanit** për zbatimin e një vendimi të **Gjykatës Kushtetuese** që ka të bëjë me **Manastirin e Deçanit**. Kësi refuzimi ka pasur edhe në rastin e vendimeve të **Gjykatës Kushtetuese** lidhur me të a.q. **VLAN** në verë të vitit 2014, mirëpo në fund u bë ekzekutimi i tyre dhe, për pasojë, erdhi deri te formimi i organeve qendrore të Republikës së Kosovës (Qeverisë së kryesuar nga **Isa Mustafa** dhe formimi i Kuvendit të Kosovës, me kryeparlamentar **Kadri Veseli**). Mbetet të shihet si do të përfundojë fati i aktgjykimit të Gjykatës në rastin e **Manastirit të Deçanit**. Për tekstin e plotë të këtij vendimi, cf. *Rasti KI 132/15. Aktgjykim. Parashtrues: Manastiri i Deçanit. Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dy vendimeve të 12 qershorit 2015, nr. AC-I-13-0008 dhe nr. AC-I-13-0009, të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 20 maj 2016. Nr. ref.: AGJ943/16.

227 VEND1M PER MOSPERMBARIM në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, të 17 dhjetorit 2010 në rastin nr. **KI 08/09** Sindikata e Pavarur e Punonjësve të Fabrikës së Çelikut, IMK, në Ferizaj, e përfaqësuar nga z. Ali Azemi, kryetar i Sindikatës - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit c. Nr. 340/2001, të 1 janarit 2002. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 6 dhjetor 2012. Në internet: https://gzk.rks-gov.net/Act Detail. Aspx? ActID=3213 (shikuar së fundi më 2 shtator 2010).

Nga sa më sipër, por edhe nga diskutimi ynë në seksionin e parë të këtij kapitulli, qartë del se fuqia e përgjithshme detyruese, **erga omnes**, nuk mund të ekzekutohet. Kjo është kështu sepse "detyrimi i përgjithshëm" (**erga omnes**) i drejtohet një grupi të adresantëve që nuk mund të përcaktohen (nuk mund të dihen). Në këtë kuptim, gjykatat kushtetuese zakonisht varen nga organet dhe institucionet e tjera shtetërore dhe publike, të cilat janë të detyruara për t'i përshtatur sjelljet e tyre me verdiktin e detyrueshëm të gjykatës kushtetuese. Nëse ky nuk është rasti, atëherë ekzekutueshmëria ngrihet si problem nga ana e atyre që afektohen me mosrespektim të vendimit të gjykatës përkatëse kushtetuese. Nga kjo del qartë se të ekzekutueshme janë vetëm vendimet e dhëna në rastet konkrete individuale: ekzekutueshmëria është koncept ngushtësisht i lidhur me efektet **res judicata**, pra jo me fuqinë e përgjithshme të detyrueshme, **erga omnes**, të cilat paraqesin cilësinë juridike të vendimeve të gjykatave kushtetuese. Kjo e fundit përcaktohet me kushtetutë, me të cilën bëhet e qartë për të gjithë se vendimet e gjykatës kushtetuese qëndrojnë sipas fuqisë së tyre juridike mbi çdo vendim tjetër të secilit organ shtetëror apo publik dhe të gjithë duhet t'i respektojnë si të tilla. Kjo cilësi nuk mund të jenë objekt ekzekutimi. Të tilla janë vetëm vendimet që kanë natyrën e **res judicata**, në rend të parë ato që kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat individuale. Vendimet meritore që kanë të bëjnë me kontrollin abstrakt të normave juridike dhe vendimet tjera të marra në procedurat ku si palë të autorizuara paraqiten subjektet e privilegjuar kushtetuese kanë natyrë të përkohshme **res judictata**. Kjo është kështu sepse në çdo kohë Gjykata mund ta ndryshoj precedentin e saj dhe gjërat të vendosura me vendim të mëparshëm t'i takojnë historisë dhe marrëdhënieve të mbyllura për atë rast konkret. Në momentin që ndryshon precedenti, vendimi i dhënë në këto lloje të procedurave **res judicata** merr cilësinë **inter partes**, njëjët si në rastin e vendimeve të marra për liritë dhe të drejtat individuale (sipas **ankesës kushtetuese**).

E përmbledhur me fjalë të tjera, kjo si më sipër nënkupton që në situatat e kontrollit abstrakt të normës, si dhe në rastet e kontrollit konkret të normës (**kontrolli incidental**), vendimet e gjykatave kushtetuese në modelin **evropian/kelsenian** kanë forcën e normës (apo aktit të përgjithshëm që përmban normën) që ka qenë objekt i kontrollit kushtetues. Kjo nënkupton se ligjvënësi apo organi tjetër që ka prodhuar normën (apo aktin e përgjithshëm që përmban normën) nuk mund të prodhoj më një produkt tjetër me përmbajtje të njëjtë jokushtetuese. Në **Gjermani** ekziston një institut i ngjashëm dhe quhet **efekti ligjor** i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Kjo është kështu sepse atje, **GJKGje** ka të drejtë të bëjë riformulimin e normave juridike gjatë kontrollit të kushtetutshmërisë së tyre, aq sa barazohet me ligjvënie.[228] Kjo nuk është kështu në rastin e **Kosovës** (së paku jo deri tani në praktikën modeste të Gjykatës Kushtetuese). Në rastin e **Kosovës**, si efekt i njëjtë me efektin ligjor nga e drejta kushtetuese gjermane mund të konsiderohet efekti i vendimeve që bëjnë kontrollin kushtetues të amendamenteve kushtetuese: në këto raste, nëse ndodh që **Kuvendi i Kosovës** miraton një amendament kushtetues sipas aktgjykimit të dhënë të Gjykatës Kushtetuese që interpreton amendamentin që ka qenë objekt kontrolli kushtetues, atëherë Gjykata del efektivisht si kushtetutëvënëse.[229]

---

228 Cf. fusnota nr. 9, **supra**, dhe diskutimet tona për efektin e ligjit të vendimeve të GJKGje.

229 Sikundër e kemi vënë në dukje më herët në seksionin 11.3.9 të kapitullit njëmbëdhjetë, **Gjykata Kushtetuese** ka anuluar përmbi 60 për qind të amendamenteve të propozuara kushtetuese, në mesin e tyre edhe amendamentin famoz që synonte ndërprerjen e parakohshme të mandatit të ish-Presidentes **Atifete Jahjaga** (ai amendament, në fakt, kishte natyrën e një vendimi individual me të cilin synohej shkarkimi nga detyra i Presidentit të Republikës. Pjesa e mbetur e amendamenteve të propozuara, të cilat nuk u shpallën si jokushtetuese nga Gjykata, asnjëherë nuk kaluan në Kuvendin e Kosovës për miratim, duke ngelur si shkronja të vdekura në letër nëpër sirtarët e këtij organi kushtetues. Cf. *Rastet K.O. 29/12 dhe K.O. 48/12. Aktgjykim. Amendamentet e propozuara kushtetuese, te dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit te Republikës së Kosovës me 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 20 korrik 2012. Nr. Ref.:AGJ 284/12.
Në një rast tjetër, i diskutuar po ashtu në seksionin 11.2 & 11.3.9 të kapitullit njëmbëdhjetë, pas mbarimit të pavarësisë së mbikëqyrur, **Gjykata Kushtetuese** ka bërë kontrollin preventiv të kushtetutshmërisë së amendamenteve më të cilat mbyllej pavarësia e mbikëqyrur e **Kosovës**. Njëri prej amendamenteve të propozuara synonte fshirjen e nenit 156 ["Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur Brenda Vendit"] të Kushtetutës. Gjykata Kushtetuese vlerësoi se ky amendament i propozuar, **amendamenti nr. 17**, nuk ishte në pajtueshmëri me Kushtetutën e Kosovës, me arsyetimin se, nëse do të miratohej ashtu siç ishte, ai do të cenonte të drejtat dhe liritë nga Kapitulli II ["Të Drejtat dhe Liritë Themelore"] i Kushtetutës. Kur ka bërë miratimin e amendamenteve të propozuara, Kuvendi i Kosovës këtë amendament e ka lënë në fuqi dhe e ka zhvendosur në Kapitullin II të Kushtetutës, ashtu siç ka propozuar Gjykata Kushtetuese. Cf. *Rasti KO 38/12.Aktgjykim. Vlerësim i kushtetutshmërisë se Propozimeve të Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës, të dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës më 12 prill 2012.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtine, me 15 maj 2012 Nr. ref.: AK 234 /12. Paragrafët 82, 93 si dhe pika II e Aktgjykimit.

Në një vend që sundon ligji, vendimet si më sipër të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës juridike supozohet se vetekzekutohen me dëshirë nga institucionet shtetërore dhe institucionet tjera publike, konform parimit të supremacisë (epërsisë) së kushtetutës dhe detyrimit për **luajalitet institucional**. Në parim, siç u tha, nuk është detyrë një gjykate kushtetuese ekzekutimi i vendimeve të saj, por i organeve të tjera të ngarkuara me një detyrim të tillë. Këto organe mund të jenë të përcaktuara me kushtetutë nacionale, ligjin për gjykatën kushtetuese, rregullat e brendshme dhe, së fundi, me vetë vendimin e gjykatës kushtetuese me të cilin vendoset çështja që duhet të ekzekutohet.[230] Në literaturë është vërejtur me të drejtë se shkalla e respektimit të **luajalitetit institucional** varet nga kultura politike dhe kushtetuese e një vendi: sa më e lartë që të jetë kjo kulturë, më shumë do të ketë respekt për vendimet e gjykatave kushtetuese dhe ekzekutimi i tyre nuk do të paraqet asnjë problem sepse secili organ do të veprojë sipas kompetencave dhe detyrimeve kushtetuese dhe ligjore që ka, dhe e kundërta, sa më e ulët që të jetë kjo kulturë politike e kushtetuese, aq më i dobët do të jetë bashkëpunimi ndërmjet institucioneve. Për pasojë, ekzekutimi i vendimeve të gjykatave kushtetuese do të jetë më i vështirë dhe do të shoqërohet me shumë probleme.[231]

Kjo që u tha për kontrollin abstrakt dhe konkret të normës juridike nuk vlen për vendimet e dhëna në rastet konkrete sipas **ankesës individuale**, ajo që në Kosovë shënohet me **KI**, gjë që na sjell sërish deri te diskutimi mbi konceptin **res judicata**.

Res judiciata paraqet një efekt të vendimeve të gjykatave kushtetuese që, në fakt, shërben si bazë për ekzekutim. Në praktikën gjyqësore gjermane, ky dallim në mes të efektit të detyrueshëm **erga omnes** dhe efektit **res judiciata** bëhet në mënyrë të qartë: në ndërkohë që ky i fundit vlen për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera shtetërore, si dhe individët, fuqia e përgjithshme detyruese, **erga omnes**, nuk vlen për autorin e vendimit, përkatësisht për vetë gjykatën kushtetuese. Se kur kemi të bëjmë me **res judicata** në kuptimin substancial përcaktohet me pjesën operative të vendimit, jo me pjesët tjera përbërëse: pjesa operative e vendimit e shpalosë përmbajtjen e normës kushtetuese që interpretohet me vendim të gjykatës kushtetuese. Pjesët tjera përbërëse, përveç pjesës operative, mund të konsultohen por asnjëherë nuk shërbejnë si dhënës të përgjigjes në atë se çka është **res judicata**. Kjo është shumë e qartë në vendimet që kanë të bëjnë me kontrollin e normës, abstrakt dhe konkret, si dhe me vendimet që jepen në kuadër të ushtrimit të juridiksioneve të tjera që kanë të bëjnë me kërkesat që nuk janë individuale. Në këto raste, arsyetimi i vendimit përbën pjesën thelbësore të verdiktit të gjykatës që shpaloset në pjesën operative. Në vendimet e dhëna në kuadër të ushtrimit (realizimit) të juridiksionit në çështjet sipas **ankesave individuale**, ndërkaq, **res judicata**, në parim, ka efekt **inter partes** ashtu që vetëm pjesa operative që ngërthen verdiktin që shpaloset me vendim shërben si pikë referimi: aty duhet kërkuar dhe gjetur objektin e ekzekutimit, adresantin dhe mënyrën e ekzekutimit të vendimit.

Kjo si më sipër, më tutje, nënkupton që te vendimet e dhëna në rastet individuale, efekti **res judicata** ka peshë më të madhe edhe për vet autorin e vendimit, gjykatën kushtetuese, e cila nuk mund ta ndryshoj atë në mënyrë arbitrare dhe pa pasur një arsye tepër të fortë, gjithnjë me kusht që ndryshimi nuk dëmton interesat e individëve që janë të përfshirë me vendim dhe as palët e treta. Sa i përket situatave që mund të lindin në të ardhmen si dhe ndryshimin e precedentit të ndërtuar në këto raste, në rastet me shenjën **KI**, çdoherë duhet pasur parasysh se vendimi i gjykatës kushtetuese nuk guxon të lëndoj substancën e të drejtës apo të lirisë së garantuar me kushtetutë.

---

230 Siegfried Bross, "Reflections on the Execution of Constitutional Court Decisions in a Democratic State under the Rule of Law on the Basis of the Constitutional Law Situation in the Federal Republic of Germany". Para. 1 fq. 4; Gunārs Kūtris, "Authority of the Constitutional Court as the Precondition of Execution of the Decisions". Në European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Conference on Execution of the Decesions of Constitutional Courts : A Cornerstone of the Process of Implementation of Constitutional Justice*. Baku, Azerbaijan, 14-15 July 2008. CDL - JU (2008) 028. Engl. only. Strasbourg 2 Septmber 2008. Në internet: https:// www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-JU(2008)028-e (shikuar më 8 korrik 2019).

231 Anahit Manasyan, "Execution of the Constitutional Court Decisions as a Guarantee for Strengthening the Constitutionalism (Example of the Republic of Armenia)", fq. 195-196.

15.5. Komente dhe pyetje

15.5.1. Sipas nenit 16.1 të Kushtetutës, vendimet e **Gjykatës Kushtetuese** kanë fuqi të përgjithshme detyruese, e njohur si efekti **erga omnes**. Kjo fuqi ka tri segmente apo dimensione të cilat shpërfaqen ndaj ambientit të jashtëm në të cilin operon vendimi pas miratimit. Cilat janë këto tri segment apo këto tri dimensione? Tregoni në veçanti nëse ky përcaktim kushtetues është specifik për Kosovën apo ekziston në secilin model të gjyqësisë kushtetuese **evropiane/kelseniane** dhe përse kjo është kështu ndër ne?

15.5.2. Nëse fuqia e detyrimit të përgjithshëm (**erga omnes**) të vendimeve të **Gjykatës Kushtetuese** përcaktohet nga vetë fizionomia e gjyqësisë kushtetuese me juridiksion të qartë të ndarë kushtetueses, në veçanti kur bëhet fjalë për **modelin evropian/kelsenian**, cilat janë cilësitë tjera të vendimeve kushtetuese që prodhojnë efekte që kanë jetë të pavarur dhe nuk derivohen nga koncepti **erga omnes**, por nga natyra e përmbajtjes së tyre konkrete? Tregoni llojet e këtyre vendimeve sipas cilësive të tjera që lidhen me natyrën e tyre juridike? Thënë me fjalë të tjera, në ndërkohë që fuqia e përgjithshme detyruese (**erga omnes**) e vendimeve kushtetuese nuk varet nga lloji i procedurës dhe çështja kushtetuese që është objekt i vendosjes, sepse të gjitha vendimet e gjykatave kushtetuese kanë fuqi të përgjithshme detyruese (**erga omnes**), ky nuk është rasti me vendimet efektet e të cilave përcaktohen sipas cilësive të tyre të brendshme. Diskutoni!

15.5.3. Llojet e vendimeve të cilat përcaktohen për nga natyra e tyre juridike, kur bëhet fjalë për vendimet e dhëna me rastin e vendosjes lidhur me **ankesat individuale** ekziston një dallim. Ky dallim buron nga fakti se **res interpretata** në kontekstin kosovar nuk ankorohet në Kushtetutë por në një praktikë gjyqësore që prodhohet në **Strasburg**. Çfarë do të thotë kjo? Pse në vendimet lidhur me ankesat individuale **res judicata** nuk shtrihet përtej pjesës operative (dispozitivit) të vendimit?

15.5.4. Cili, atëherë, nisur nga komentet si më sipër, është dallimi në mes të fuqisë së përgjithshme detyruese (**erga omnes**) të vendimeve të gjykatave kushtetuese të modelit evropian/kelsenian dhe efekteve konkrete të vendimeve të këtyre gjykatave të dhëna në vijim të ushtrimit të kompetencave të tyre kushtetuese, përkatësisht dallimi në mes të efekteve **res judicta**, **inter partes** dhe **stare decisis** të një vendimi kushtetues?

15.5.5. Për doktrinën **stare decisis** tanimë kemi bërë fjalë në kapitujt pararendës. Këtu ka rëndësi të diskutohet sërish për këtë doktrinë, tani në kuptim të efektit juridik të vendimeve të gjykatave kushtetuese. Në këtë kuptim, **stare decisis** në vetvete përbën një efekt specifik: vetë doktrina **stare decisis** ndërtohet në efektin e caktuar juridik të vendimeve juridiksionale brenda rendit juridik nacional. Ai efekt specifik konsiston në fuqinë e detyrueshme baras me kushtetutën dhe ligjin për aq sa çështja që zgjidhet ka identitet të njëjtë faktit dhe juridik me vendimin e kaluar (**stare decisis**). A përfshihet efekti **stare decisis** me nenin 116.1 të Kushtetutës? Nëse përgjigja është po, atëherë tregoni mënyrën dhe caqet e kësaj përfshirjeje me fokus të veçantë në marrëdhënien në mes të **stare decisis** dhe vendimmarrjes së gjykatave kushtetuese, përkatësisht a i obligojnë vendimet e mëhershme gjykatat kushtetuese dhe në çfarë mase?

15.5.6. Cili është dallimi në mes të koncepteve si vijon: **obiter dicta**, **mendimi mospajtues** dhe **masa e përkohshme**?

15.5.7. Për nga natyra e tyre juridike, përkatësisht për nga sasia dhe cilësia e të drejtave dhe detyrimeve që përçojnë lidhur me palët dhe për ambientin e përgjithshëm përreth, vendimet e gjykatave kushtetuese ndahen në dy grupe të mëdha. Cilat janë ato dy grupe të mëdha të vendimeve të gjykatave kushtetuese sipas kriterit si më sipër dhe cilat janë arsyet për shkak të të cilave ato ekzistojnë që nga lindja e gjyqësisë kushtetuese **evropiane/kelseniane**?

15.5.8. *Në tenorët/verdiktet (pjesët operative) e vendimeve meritore që japin përgjigje negative lidhur me kushtetutshmërinë e normës/ligjit, përkatësisht në tenorët/verdiktet (pjesët operative) që shpallin (deklarojnë/gjejnë) se norma/ligji është jokushtetues gjenden formulime dhe shprehje të ndryshme për*

*të përshkruar pasojat imediate që godasin atë që ka qenë **thema decidendum**. Ato shprehje e formulime zakonisht janë si vijon: "**norma/ligj është pa asnjë fuqi**", "**norma/ligji është i pavlefshëm**", "**norma/ligji është i pa aplikueshëm**", "**shfuqizohet norma/ligji**", apo "**norma/ligji më nuk është në forcë**". Kush përcakton përdorimin e këtyre shprehjeve dhe si është kjo në gjyqësinë kushtetuese të Kosovës?*

15.5.9. Në praktikën e gjykatave kushtetuese me kontrollin abstrakt të normave juridike (atyre kushtetuese, ligjore apo normave të tjera më karakter të përgjithshëm), në të shumtën e rasteve vendimi është në favor të ruajtjes së aktit të përgjithshëm juridik të sfiduar (apo të pjesëve të caktuara të tij). Kjo nënkupton, për pasojë, refuzimin e kërkesës për shpalljen si jokushtetues të aktit të përgjithshëm (apo pjesëve të caktuara të tij). Vendimet e dhëna në këto raste, konfirmojnë **parimin e prezumimit të kushtetutshmërisë** së normave të përgjithshme juridike, të përmbajtura në aktin e sfiduar juridik. Si të tilla, këto vendime kanë fuqi të përgjithshme detyruese (**erga omnes**) në pjesën dërrmuese të sistemeve kushtetuese që i takojnë modelin **evropian/kelsenian**. I tillë është rasti, ta zëmë, me gjykatat kushtetuese të vendeve si vijon: **Republika Çeke**, **Franca**, **Gjermania**, **Hungaria**, **Polonia** dhe **Spanja**. Në këto vende, megjithatë, bëhet dallim i qartë në mes të fuqisë së përgjithshme detyruese (**erga omnes**) të vendimeve dhe cilësisë së tyre të të qenit vendime të ekzekutueshme. Diskutoni!

15.5.10. Vendimet e gjykatave kushtetuese të dhëna në procedurat e kontrollit incidental kanë fuqi të përgjithshme juridike (**erga omnes**). Pse kjo është kështu në pjesën dërrmuese të vendeve që kultivojnë gjyqësi kushtetuese **kelseniane/evropiane**? Kur themi në pjesën dërrmuese, atëherë nënkuptohet se ekzistojnë disa përjashtime. Gjyqësia kushtetuese e cilave vende paraqet përjashtim sipas të cilit vendimet e gjykatës kushtetuese të dhëna në procedurat e **kontrollit incidental** nuk kanë fuqi të përgjithshme detyruese (**erga omnes**)? Këtu nuk e kemi fjalën vetëm për **Italinë**, por edhe për disa vende të tjera. Diskutoni!

15.5.11. Siç kemi folur më herët në fillim të këtij seksioni, thuajse të gjitha gjykatat kushtetuese në **Evropë** dhe gjetiu kryejnë interpretime kushtetuese që janë konform kushtetutës (**constitution - confirm interpretation**). Në fakt, ky lloj interpretimi apo kjo metodë pune e gjykatave kushtetuese nuk gjen vend vetëm në praktikën e gjyqësisë kushtetuese **evropiane/kelseniane** por edhe në vendet e **sistemit të së drejtës së përgjithshme**, të cilat nuk kanë gjykatë të ndarë kushtetuese (këtë funksion e luan gjykata më e lartë në vend). Në rastet e vendimeve të tilla, gjykatat nuk lënë pa konstatuar të metat apo problemet kushtetuese të normës juridike/ligjit, mirëpo nuk bëjnë anulimin e tyre. Çfarë bëjnë në vend të kësaj?

15.5.12. Situatë e ngjashme na paraqitet edhe tek vendimet e gjykatave kushtetuese, që nuk janë të rralla, me të cilat shtyhet në kohë efekti i jo kushtetutshmërisë së gjetur: ka raste kur gjykatat kushtetuese konstatojnë jo kushtetutshmërinë e një norme/ligji apo disa syresh, si dhe të ligjit marr si tërësi, mirëpo vendosin të shtyjnë efektet kohore të këtij konstatimi. Pse?

15.5.13. Jo vetëm kaq! Në gjyqësinë kushtetuese gjermane dhe italiane ekziston edhe një praktikë tjetër shumë më specifike se këto si më sipër. Në këto dy raste, jo vetëm që konstatohet jo-kushtetutshmëria e një norme apo ligji dhe nuk bëhet anulimi i tyre, por edhe mund të vij deri te situata kur gjykata kushtetuese vendos që një ligj pritet të bëhet jo-kushtetuese ma kalimin e kohës së caktuar. Çfarë do të thotë kjo? Si dhe përse ndodh një gjë e tillë? A përdoret shpesh kjo teknikë interpretimi? Diskutoni këto aspekte përmes rasteve të përmendura në libër nga përvoja e gjyqësisë kushtetuese së këtyre vendeve, në të cilat është konstatuar jo kushtetutshmëria e përkohshme. Tregoni në veçanti fuqinë juridike të vendimeve të marra në këto raste, si dhe dallimin e tyre me rastet e tjera të zakonshme ku jo kushtetutshmëria ka fuqi imediate.

15.5.14. Vendimet që gjejnë shkelje kushtetuese janë, në fakt, një **modus operandi** i zakonshëm dhe një standard i gjyqësisë kushtetuese **kelseniane/evropiane**: sikundër dihet, gjykatat kushtetuese kanë lindur si përgjigje ndaj cilësisë normative që kushtetutat kanë fituar me kalimin e kohës, me qëllim të sigurimit të një statusi superior (epërsi) të vlerave, parimeve dhe normave kushtetuese kundrejt vlerave, parimeve dhe normave të tjera juridike. Forma e parë e manifestimit të këtij aktiviteti të gjykatave kushtetuese

ka qenë sjellja e tyre si **ligjvënës negativ**. Me kalimin e kohës ka ardhur deri te pasurimi i formave të veprimit të gjykatave kushtetuese, të cilat tejkalojnë konceptin origjinal të **ligjvënësit negativ**. Në çka konsistojnë këto forma të reja, që dallojnë nga dikotomia e zakonshme **shkelje kushtetuese - anulim norme/ligji**?

15.5.15. Në rastet e anulimit të normës/ligjit, vlen një tjetër parim i pashkruar, sipas të cilit gjykatat kushtetuese zakonisht procedojnë me anulimin e dispozitave juridike për aq sa është e nevojshme për të ndrequr gjendjen jo kushtetuese. Vendet e sipërcekura, në të gjitha rastet, autorizojnë gjykatat e tyre që të anulojnë pjesërisht apo në tërësi dispozitat e aktit të kontestuar. Në këtë kategori hyn edhe rasti i Kosovës: neni 29 i **Ligjit Nr. 03/L-121** përcakton se kërkesa "[…] duhet të specifikoje, *inter alia*, nëse i tërë akti i kontestuar apo pjesë të veçanta të këtij akti konsiderohen të jenë në kundërshtim me Kushtetutën." Kjo dispozitë shtjellohet tutje në rregullin 67.2 të **RP**. Kështu veprohet edhe në jurisprudencën e **Gjykatës Kushtetuese.**

Kjo qasje që autorizon anulimin e tërësishëm apo të pjesshëm të aktit të sfiduar juridik bëhet gjithnjë me shpresë se një pjesë e aktit të sfiduar mund të vazhdojë jetën autonome, pa e humbur kuptimin dhe arsyetimin e qëllimit fillestar për çka është nxjerr. Kjo ka për synim arritjen e dy qëllimeve. Për çfarë qëllimesh bëhet fjalë?

15.5.16. Në mes të teknikës së **interpretimit në pajtim me kushtetutën** dhe **teknikës së anulimit të pjesshëm** të aktit juridike ekziston një dallim thelbësor: në rastin e parë, ligji ruhet, ai nuk anulohet, me kusht që t'i përmbahet interpretimit të dhënë nga gjykata kushtetuese, gjithnjë duke respektuar maksimalisht qëllimin fillestar të ligjvënësit. Te rastet e **anulimit të pjesshëm**, ndërkaq, ligji anulohet pjesërisht për aq sa ka të bëjë me situatat e parashikuara në te apo me situata të tjera që gjykata kushtetuese mendon se mund të krijohen në të ardhmen. Diskutoni këtë përmes shembullit të dhënë në libër!

15.5.17. Në literaturë, përvojat **gjermane** dhe **italiane** mjaft shpesh merren si shembull i përvojave interesante për sa i përket modaliteteve të anulimit të pjesshëm të aktit juridik. Në fakt, në praktikë rrallëherë paraqitet nevoja për anulim të tërësishëm të normës/ligjit. Kështu është edhe në **Kosovë** dhe në përvojën e saj modeste me gjyqësinë kushtetuese deri më sot. Në libër përmendet rasti i vendimit për anulimin e **Ligjit nr. 06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shteteror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë**. Diskutoni këtë rasti përmes analizimit dhe hapjes së debatit rreth arsyetimit të Gjykatës Kushtetuese në këtë rast.

15.5.18. Në rastet kur ndodhë anulimi, efekti praktik i vendimit është **ex tunc**. Për të sanuar këtë efekt, gjykatat kushtetuese në këto dy vende kanë sajuar teknika që zbusin dukshëm efektin **ex tunc** dhe pasojat që e shoqërojnë. Për cilat teknika bëhet fjalë? Në gjyqësinë kushtetuese të të cilave vende këto teknike kanë gjetur shprehje?

15.5.19. Në seksionin e dytë të kapitullit të 14-të kemi folur për lindjen dhe kuptimin e teorisë dhe praktikës italiane të **diritto vivente:** lindja ja e saj ka ndodhur në vazhdën e luftës në mes të gjykatave më të larta italiane, **GJSKIt** dhe **GJKIt**. Kjo e fundit, duke qenë gjykatë e re, në fillim të punës së saj ka hasur në vështirësi të mëdha dhe në rezistencë të **GJSKIt**. Për të krijuar një harmoni në mes tyre, dhe për të siguruar zbatimin e vendimeve të **GJKIt**, kjo e fundit krijoj teknikën e prodhimit të vendimeve të a.q. **sentence interpretative**. Realizimi i një teknike të tillë është bërë e mundur përmes dallimit që e ka krijuar **GJKIt** në mes të tekstit kushtetues (**disposizione**) dhe përmbajtjes së tij apo sjelljes që kërkohet nga teksti (**norma**). Çfarë do të thotë kjo? Diskutoni!

15.5.20. Në kontesktin e diskutimit për **diritto vivente** është vënë në dukje se ekzistojnë dy forma të **sentenze interpretative:** forma e parë quhet **sentenza intepretativa di rigetto,** kurse e dyta **sentenza interpretativa di accoglimento.** Cili është dallimi ndërmjet tyre?

15.5.21. Në teorinë dhe praktikën italiane ekzistojnë disa klasifikime të **aktgjykimeve manipulative**. Ndër to, kemi veçuar për diskutim për sa vijon: **sentence ablative** (aktgjykimet shkëputëse), **senten-**

ze sosituive (aktgjykimet zëvendësuese) dhe **sentence additive** (aktgjykimet shtuese). Vetëm **sentence interpretative di rigetto** dhe **sentenze interpretative di accoglimento** normohen me Kushtetutë dhe Ligjin për GJKIt. Në tërësi produkt i praktikës ë pasur gjyqësore italiane janë **aktgjykimet manipulative,** përkatësisht janë rezultat i **aktivizmit gjyqësor** të **GJKIt**, e cila, për të rregulluar raportet e saj me gjyqësorin dhe me ligjvënësin ka zbuluar modalitete të vendimmarrjes që nuk konsistojnë në anulimin e ligjeve e as në interpretimin e tyre në pajtim (harmoni) me Kushtetutën. Diskutoni!

15.5.22. Në ndërkohë qe **sentenze interpretative** janë krijuar me norma të qarta kushtetuese dhe ligjore respektive italiane, **sentence manipolative** kanë origjinën në praktikën e pasur të gjyqësisë kushtetuese italiane. Në dekadat e para të themelimit të **GJKIt** ka pasur nevojë që t'i jepet më shumë fuqi gjyqësorit të rregullt, me norma kushtetuese dhe ligjore, si implementues direkt i ligjeve të vjetra nga **koha fashiste**, që të reflektojë dhe të vetëdijesohet për nevojën e eliminimit gradual nga sistemi juridik - kushtetues italian të ligjeve dhe dispozitave ligjore arkaike të kohës së **Fashizmit**, jo vetëm në sferën penale por edhe në sferën e të drejtës administrative, familjare, të pronësisë industriale, të taksave dhe kështu me radhë, ligje që rrënonin garancionet themelore kushtetuese mbi lirinë personale, lirinë e shprehjes, rolin dhe pozitën e fesë etj., etj.. Për këtë arsye janë krijuar dy llojet e (sipërcekura) të **sentenze interpretative**: i pari për të konfirmuar kushtetutshmërinë e ligjeve të vjetra kur ato nuk janë kundërkushtetuese, kurse i dyti për të braktisur praktikën e vënies në jetë të ligjeve arkaike fashiste, duke u mbështetur në një **normë të re** të krijuar si **diritto vivente** nga **GJSKIt**, duke injoruar tekstin ekzistues kushtetues. Kjo nuk vjen në shprehje në **sentenze manipolative** sepse, thjeshtë, në rastin e tyre, siç e thonë autorët italian me renome, **manipulimi** i tekstit të normës abstrakte ose i normës (e kuptuar si **diritto vivente**), përbën **transformim** (modifikim) të tyre në vend të eliminimit të të njëjtave nga sistemi juridik – kushtetues ose interpretimit në pajtim me **Kushtetutën Italiane**. Kjo bëhet e qartë nga përmbajtja e tri modaliteteve të aktgjykimeve manipulative: **sentence ablative** (aktgjykimet shkëputëse), **sentenze sosituive** (aktgjykimet zëvendësuese) dhe **sentence additive** (aktgjykimet shtuese). Sqarimit të këtyre modaliteteve duhet t'iu ktheheni për diskutim gjatë orëve tuaja!

15.5.23. Nuk ka vend në **Evropë** që përqafon formën e pastër të efektit **ex tunc** ose **ex nunc** të vendimeve të gjykatave të tyre kushtetuese. Lloj-lloj modifikime kanë lindur në sferën e menaxhimit të kujdesshëm të efekteve kohore të vendimeve të gjykatave kushtetuese mbi jokushtetutshmërinë e akteve juridike (të përgjithshme ose individuale). Diskutoni nisur nga përvoja e **Francës**, **Italisë** dhe **Spanjës**!

15.5.24. Pa marrë parasysh dallimet fillestare në pikëpamje të efekteve **ex tunc** dhe **ex nunc** të vendimeve të tyre që shpallin si jo kushtetues një normë abstrakte ose ndonjë masë tjetër shtetërore, gjykatat kushtetuese nuk kanë dallime të mëdha në praktikë. Rregull i përbashkët i dy grupimeve të shteteve si më sipër është se vendimet e gjykatave kushtetuese, zakonisht janë të zbatueshme që nga koha e publikimit të tyre, përkatësisht nga dita e nesërme e publikimit të tyre në gazetën zyrtare nacionale. Si është kjo në Kosovë?

15.5.25. A mund gjykatat kushtetuese vetë të përcaktojnë datën kur anulimi nis prodhimin e efekteve të veta juridike, në një kohë që norma abstrakte jo kushtetuese (apo akti tjetër juridik) humb fuqinë e vet detyruese? Rëndësia e kësaj pyetje është vërejtur edhe në praktikën e **Gjykatës së Strasburgut,** e cila qysh në vitin 2010 ka bërë fjalë, në një vendim të saj, për rëndësinë e dallimit në mes të humbjes së fuqisë detyruese të normës së shpallur si jo kushtetuese dhe zbatimit të saj përgjatë një kohe kalimtare, përkundër të qenit të saj jo kushtetuese. Ka rëndësi që kjo situatë të lejohet dhe të përligjet sepse, gjithnjë sipas **Gjykatës së Strasburgut**, fort duhet pasur parasysh respektimin e parimit të sigurisë juridike dhe të parashikueshmërisë në shfrytëzimin e lirive dhe të drejtave të garantuara me **KEDNJ.** Diskutoni këtë, me vështrim të veçantë në sferën sociale, të taksave, privatizimit dhe restitutimit të pronave!

15.5.26. Përvojat e gjyqësisë kushtetuese **kleseniane/evropiane** në ndërkohë kanë avancuar aq shumë sa që sot jo rrallë gjejmë praktika juridiksionale të gjykatave kushtetuese që e shkëpusin lidhjen **shkak** (norma jo kushtetuese) – **pasojë** (anulimi i normës jo kushtetuese). Nga përvojat e shumta të shkëputjes së tillë të lidhjes shkakore, lidhje që shërben si definuese e gjyqësisë klasike kushtetuese negative, një

rëndësi të veçantë kanë përvojat e tri vendeve më reprezentative të kësaj shkëputje të lidhjes shkakore: **Gjermania**, **Italia** dhe **Spanja.** Diskutoni këto tri vendet dhe shembujt e përvojës së tyre me shkëputjen e lidhjes shkakore në mes të normës jo kushtetuese dhe anulimit të saj!

15.5.27. Lidhur me strukturën e argumenteve kushtetuese, pyetja që shtrohet është si vijon : cila është struktura e zakonshme (standarde) e argumenteve të dhëna në një vendim? Në këtë kuptim, në hulumtimet krahasimore janë vërejtur tri lloje të strukturave të argumentit kushtetues, të cilat përdoren në vendimmarrjet në gjyqësinë kushtetuese. Cilat janë ato lloje?

15.5.28. Ekzistojnë disa lloje të argumenteve kushtetuese që përdoren për formimin e strukturave argumentuese, të cilat ju supozohet që tanimë i keni mësuar. Cilat janë llojet e argumenteve të cilat, sipas hulumtimeve krahasimore është vërejtur se janë përdorur (ose janë refuzuar për t'u përdorur) më së shumti?

15.5.29. Një praktikë që shumë i ngjanë përvojës së **Kosovës** me gjyqësinë kushtetuese post-komuniste paraqet rasti i **Çekisë**. **GJKÇe** nxjerr aktgjykime që nisin me përshkrimin e shkurtër të rastit, pasuar nga prezantimi i argumenteve të palëve. Më pas fillon përshkrimi i saktë i fakteve të rastit (në veçanti kur bëhet fjalë për rastet e procedurave të iniciuara sipas ankesës kushtetuese, e cila ka natyrë të njëjet si në Kosovë (ankesë e plotë). Kjo nganjëherë e bën aktgjykimin çek relativisht kaotik, thuhet në literaturë. Arsyetimi i meritave të aktgjykimit më pas ndahet në disa seksione që përbëjnë meritat e rastit, ku **GJKÇe** për secilin argument të palëve jepet një arsyetim të saj, si dhe konkluzionet për secilin argument veç e veç. Kjo e bën të qartë stilin e argumentimit, përkatësisht strukturën e tij: kryesisht dominon argumenti "**këmbët e karriges**", e më pak **struktura e argumenteve me një rresht** ("**rrathët lidhës zinxhiror**"). Dominimi i strukturës argumentuese "**këmbët e karriges**" shpjegohet me faktin se kjo mënyrë arsyetimi ka të bëj me **silogjizmin**, i cili konsiderohet si nj model ideal i arsyetimit juridik në përgjithësi, përfshirë këtu të drejtën kushtetuese dhe gjyqësinë e saj. Përzgjidhni dy aktgjykime të **Gjykatës Kushtetuese të Kosovës** dhe analizoni ato në dritën e këtij sqarimi të praktikës gjyqësore ceke. Pasi ta keni bërë këtë, përzgjidhni dy aktvendime të **Gjykatës Kushtetuese të Kosovës** dhe tregoni se si janë ato të strukturuara dhe cilat janë llojet e argumenteve të përdorura aty.

15.5.30. Sa i përket vendimeve që arsyetohen me përdorimin e **argumenteve me strukturë dialoguese**, të cilat janë shumë të rralla në praktiken e **GJK*Çe,*** vlen të veçohet rasti i kontrollit kushtetues të dekreteve presidenciale që kanë pasur për objekt marrjen (heqjen) e shtetësisë çekosllovake gjermanëve dhe hungarezëve etnik pas Luftës së Dytë Botërore, veprim që ka rezultuar në dëbimin e tyre dhe humbjen e pronave. Ky rast është nisur me ankesë kushtetuese të një gjermani etnik, dikur shtetas çekosllovak, i cili kërkoi anulimin e dekreteve presidenciale të pas **Luftës së Dytë Botërore** dhe rikthimin e pronave të humbura pa të drejtë. Me këtë rast, **GJK*Çe*** *shkroi një vendim shumë të gjatë, me të cilin provoi të kryej një rivlerësim të historisë nacionale. Kjo rrethanë e bën këtë vendim atipik, jo të zakonshëm për një tekst juridik: argumentet pasiononte të përdorura në vendim, më shumë i ngjasojnë një mbrojtjeje historike të veprimeve të qeverisë së* **Çekosllovakisë** pas vitit 1945. Në vend të kësaj, ***GJKÇe është dashur të mbahet fort pas kompetencave juridiksionale, të cilat nuk lejojnë kontrollin kushtetues të akteve juridike që nuk janë në fuqi dhe që nuk zbatohen më, përkatësisht të akteve juridike pasojat juridike të të cilave janë prodhuar dhe kanë kryer efektet e tyre pesëdhjetë vite më herët.*** **GJK*Çe***, *megjithatë, nuk e ka bërë një gjë të tillë. Kjo ka ndodhur përmes një vendimi të natyrës së* ***argumenteve më strukturë dialoguese****, të cilat zakonisht përdoren si rezultat i paaftësisë së gjykatave apo të gjyqtarëve për të shkruar vendime duke prodhuar argumente koherente që i përshtaten modelit të strukturës së* ***argumenteve*** **me një rresht** ("**rrathët lidhës zinxhiror**") ose argumenteve që kanë strukturën "**këmbët e karrigës**". Kjo nënkupton se, modeli dialogues rrjedh si pasojë e paaftësisë për të qenë koherent në argumentim, përkatësisht për shkak të paaftësisë për të operuar si duhet me teknikën e silogjizmit *me rastin e interpretimit juridik. Në vend të kësaj vjen deri te hapja e rrugëve arsyetuese në vendim dhe dhënia e argumenteve që nuk kanë ndonjë relevancë me rastin. Në* ***Kosovë,*** *si shembull tipik i këtij modeli të argumentimit dialogues, konfuz dhe jokoherent, është Aktgjykimi lidhur me rastin e* ***Asociacionit Serb****. Lexoni këtë aktgjykim në grup, me shumë kujdes, pastaj hapni debat ndërmjet veti duke gjetur pikat që e bëjnë konfuz dhe jokoherent.*

15.5.31. Si një gjykatë më funksion të dyfisht, si një gjykatë kushtetuese që vë standarde garantuese të mbrojtjes minimale të lirive dhe të drejtave të garantuara me **KEDNJ** dhe si mbikëqyrëse e vënies së saj në jetë, **Gjykata e Strasburgut** në kontekstin kushtetues kosovar gëzon një status të veçantë dhe ka një peshë jashtëzakonisht të madhe kushtetuese: nenit 53 i Kushtetutës, tani më i njohur për të gjithë, e cakton si një detyrim për të gjitha autoritetet publike që me rastin e vendosjen për liritë dhe të drejtat kushtetuese vendimet e tyre t'i bazojnë në tërësi në interpretimet e bëra në **Strasburg**, pra në harmoni të plotë me standardet e vëna nga **GJEDNJ**. Ky fakt i vetëm mjafton për të trajtuar **Gjykatën e Strasburgut** edhe në aspektin e pa trajtuar deri më tani – atë të strukturës argumentuese të arsyetimeve të vendimeve të saj dhe të llojit të argumenteve të përdorura aty. Së pari diskutoni llojin e argumentit dhe parimet mbi të cilat bazohet vendimmarrja, pastaj kaloni në strukturën e argumentit kushtetues. Përveç kësaj, në arsyetimin e saj me karakter kushtetues, të përshkruar si më lartë, **Gjykata e Strasburgut** i përmbahet disa parimeve themelore. Për cilat parime bëhet fjalë këtu?

15.5.32. Në literaturë bëhet dallimi në mes të arsyetimit kushtetues në kuptimin e ngushtë (**stricto sensu**) dhe arsyetimit kushtetues në kuptimin e gjerë (**sticto latu**), të cilat **GJED** i përdor me rastin e vendosjes për mbarë hapësirën e **UE**-së. Çfarë do të thotë kjo? Diskutoni!

15.5.33. Tradita e gjyqësisë franceze në përgjithësi, përfshirë atë kushtetuese, niset nga premisa e vjetër sipas së cilës gjyqtarët janë vetëm zbatues teknik të normës juridike kundrejt fakteve të lindura jetësore, fakte të cilave iu dedikohet norma që zbatohet dhe për të cilat bën fjalë në mënyrë ekskluzive. Kjo traditë ka rrënjët e saj në **Francën** pas revolucionare, e cila asnjëherë nuk ka arritur të dal jashtë kornizës së saj formale, diskrete dhe të mjegullt të arsyetimeve gjyqësore, me një qasje të tepruar formaliste. Kjo qasje formaliste, ku rrallë herë bëhet fjalë për shpirtin e normës juridike dhe rolin kreativ të gjyqtarit, në literaturë është cilësuar si kuazi-silogjizëm. Kjo edhe nisur nga fakti se vendimet e **KKF** fillojnë me fjali formale që u ngjasojnë shumë rezolutave të organeve ndërkombëtare apo të ndonjë preambule kushtetuese. Kjo e bën karakteristike arsyetimin kushtetues francez. Nisur nga kjo, cila strukturë argumentuese dhe cili lloj i arsyetimit mbretëron në vendimet e **KKF**?

15.5.34. Një situatë e kundërt me praktikën franceze, në fakt shumë më e ndryshme se krejt rastet që diskutuam deri këtu, paraqitet praktika e **GJKGje**, liria metodologjike e së cilës ka krijuar nga e drejta kushtetuese një udhëzues të pakontestueshëm për politikën, gjyqësorin dhe autoritetet tjera publike. Vendimet e saj në arsyetim paraqiten si deduktive dhe teknike, mirëpo operojnë, në të njëjtën kohë, me koncepte shumë të gjëra dhe të hapura që kanë një analizë qëllimore. Me përjashtim të viteve të para të punës, **GJKGje** ka arritur të krijojë një standard arsyetimi jashtëzakonisht të saktë dhe me struktura doktrinare të përpunuara deri në detaje, aq sa leximi dhe analizimi i vendimeve të saj duket si një çështje krejtësisht e lehtë dhe teknike. Në dëshmi të kësaj, mjafton të rikujtohen arsyetimet e **GJKGje** në vendimet lidhur me, ta zëmë, **kuptimin e lirisë si një e drejtë reziduale** (që çdoherë ka substancë të gjallë jashtë definimit tekstual kushtetues të kuptimit të lirisë), **efektet indirekte horizontale** të së drejtës kushtetuese gjermane bazuar në **Ligjin Themelor** (**LTH**) si një " rend objektiv i vlerave", dhe, së fundi, **analizën apo testin e proporcionalitetit**. Në veçanti dy doktrinat e fundit përbëjnë modelet më së shumti të eksportuara në botën e jashtme, të pranuara dhe të përqafuara nga shumë kushtetuta e gjykata kushtetuese. Analizoni më kujdes këto standarde të vëna nga kjo gjykatë dhe gjeni dallimet dhe ngjashmëritë me standardet e gjyqësisë kushtetuese kosovare, në veçanti shikoni nëse këto praktika gjermane mund të jenë të zbatueshme edhe në Kosovë!

15.5.35. Në gjyqësinë kushtetuese të **Izraelit**, përkundër që ky vend ka qenë nën ndikimin e fortë të Britanisë së Madhe, si ish-koloni e saj, njëjtë si Irlanda. **GJSIz**, deri në vitin 1992 ka prodhuar vendime të natyrës kushtetuese të arsyetuara kryesisht mbi bazën e tekstit ekzistues ligjor, pa parë atë tekst ndonjë vlerë normative. Kjo nënkupton që, në dekadat e para formative të **Shtetit të Izraelit**, ka dominuar parimi i ndarjes së pushteteve, ku gjyqtarët kanë vetëm fuqi interpretuese të produkteve të **Knesset**-it (**Parlamenti i Izraelit**). Në këtë kuptim, ndikimi britanik i supremacisë (epërsisë) së ligjit, në këtë fazë, ka qenë dominant. Kjo gjendje ka ndryshuar në vitet 1992 dhe 1994 respektivisht. Në këto dy vite u

nxorën dy ligje mbi të drejtat e njeriut, të cilat përmes interpretimit të **GJSIz** në mënyrë graduale kanë fituar statusin e teksteve që përbëjnë norma me fuqi kushtetuese, përkatësisht me fuqi më të lartë normative se çdo normë tjetër ligjore. Kjo u cilësua si "**revolucion kushtetues**", cilësim që lidhet me një vendim dhe me një personalitet izraelit. Diskutoni si ka ardhur deri te ky revolucion kushtetues, për cilat vendime bëhet fjalë dhe për cilin personalitet izraelit!

15. 5. 36. Zhvillimet në gjyqësinë kushtetuese izraelite kanë pasur efekt edhe ndaj strukturës së argumentit kushtetues të prodhuar në vendimet e **GJSIz**. Në të shumtën e rasteve, në fillim Gjykata ekspozon (paraqet) parimet themelore të cilat shërbejnë si bazë për zgjidhjen e rastit konkret, parime që derivohen nga vendimet e mëhershme (**stare decisis**) dhe më pas zbatohen ndaj rastit konkret. Këto vendime kryesisht kanë **strukturë zinxhirore lineare**, d.m.th. përdoret vetëm një argument konkluziv për vendosjen e rastit. Argumenti **këmbët e karriges**, përkatësisht përdorimi i më shumë argumenteve me fuqi të njëjtë të pavarur konkluzive për zgjidhjen e rastit përdoret shumë më pak. Në literaturë është shënuar se janë tepër të rralla rastet e vendimeve që përdorin **argumente dialoguese**, përkatësisht argumente që nuk janë përfundimtare në mënyrë autonome por vetëm nëse përdoren në mënyrë kumulative. I tillë është rasti **Eisenberg**, i cili ka pasur të bëj me një ankesë kundër emërimit të një personi me të kaluar kriminale të vërtetuar me vendim gjyqi në pozitën e drejtorit të përgjithshëm në një ministri në **Izrael**. Diskutoni si ka arsyetuar në këtë rast **GJSIz**.

15.5.37. Sa i përket strukturës argumentuese, vlen të theksohet se në gjyqësinë kushtetuese italiane nuk ekziston një strukturë dominante e argumentimi: në dekadat e para të jetës dhe punës së **GJKIt** kanë dominuar vendimet me **stil zinxhiror të argumentimit**, i cili edhe sot akoma ekziston krahas strukturës argumentuese **këmbët e karriges** dhe **strukturës dialoguese** (në këtë të fundit, asnjë argument në mënyrë të pavarur nuk çon në një përfundim por vetëm nëse lexohen dhe kuptohen si një tërësi e marrë së bashku). Diskutoni shkaqet dhe arsyetimet për një gjendje të tillë.

15.5.38. Në gjyqësinë kushtetuese italiane dominojnë argumentet jozinxhirore dhe kjo ka një shpjegim që lidhen me tri rrethana: e para është se në këtë gjyqësi nuk njihen mendimet mospajtuese dhe mendimet konkurruese; e dyta ka të bëj me faktin se pjesa dërrmuese e gjyqtarëve kushtetues italian vijnë nga bota akademike universitare; dhe, së fundi, palët e treta nuk mund të paraqiten si palë në procedurat pranë **GJKIt**. Diskutoni!

15.5.39. Në frymën e traditës **evropiane/kelseniane** të gjyqësisë kushtetuese, **TKSp** manifeston dy cilësi të përbashkëta me këtë traditë: e para, vendimet e saj në vitet e para formative, njëjtë si në **Kosovë** dhe gjetiu nëpër **Evropë**, përshkohen nga shtjellimet doktrinare dhe me fuqi të theksuar precedenciale (thuajse në çdo pikë të realizimit kompetencave të veta juridiksionale); dhe, e dyta, struktura dominuese argumentuese është **zinxhirore me një argument konkluziv**, gjë që akomodon botëkuptimin tradicional evropian (dhe kosovar) që aktgjykimin e sheh si një produkt të silogjizmit gjyqësor, ku konkluzioni del natyrshëm dhe logjikshëm nga procesi i nënvënies (**subsumcionit**), përkatësisht nga barazimi i dy premisave. Ky proces përfshin ndërmarrjen e disa hapave esencial paraprak me qëllim të përcaktimit të premisave. Për çka bëhet fjalë këtu? Diskuto!

15.5.40. Të gjitha vendimet e **GJKRKS**, sa i përket strukturës argumentuese, mund të ndahen në dy grupe të mëdha: në grupin e parë hyjnë vendimet që kanë **strukturë zinxhirore** me një argument ("**one line single conclusive argument**") kurse në të dytin janë vendimet **këmbët e karriges**, me shumë argumente konkluzive që mund të përdoren në mënyrë të pavarur ("**chain of arguments, mutually conclusive arguments**"). Diskutoni!

15.5.41. Në përvojën e shteteve të ndryshme, përfshirë **Kosovën**, në përgjithësi mund të thuhet se ekzistojnë dy rrugë apo dy zgjidhje sa i përket ekzekutimit të vendimeve të gjykatave kushtetuese. Cilat janë ato? Diskutoni!

15.5. 42. Gjykata mund të specifikojë në vendimin e saj mënyrën dhe afatin kohor për ekzekutim të vendimit të saj, sqarohet në dispozitën e rregullit 66. 4 të **RP**. Organi që duhet të zbatojë vendimin është i paracaktuar nga fakti i origjinës së aktit juridik apo veprimit tjetër që është objekt i kontrollit kushtetues: ai çdoherë është autoritet shtetëror ose autoritet tjetër publik. Çfarë do të thotë kjo?

15.5.43. Një çështje me rëndësi që shtrohet ka të bëj me përcjelljen e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës: cili organ e bën një gjë të tillë? Laikët mund të mendojnë për një autoritet të jashtëm si për organin që bën mbikëqyrjen e ekzekutimeve të Gjykatës Kushtetuese. Kjo, megjithatë, nuk është kështu: sipas nenit 66.8 të **RP**, Sekretariati, nën mbikëqyrjen e gjyqtarit, i cili në pajtim me rregullin 58 të **RP** e ka hartuar vendimin, do ta përcjellë zbatimin e vendimit, si dhe, sipas nevojës, do t'i raportojë Gjykatës lidhur me rekomandimin për procedurat e mëtejmë ligjore që duhet të ndërmerren. Në fillim të shtatorit të vitit 2012, me propozimin e kryetarit të parë të Gjykatës Kushtetuese, është formuar një komitet **ad hoc** që ka pasur për qëllim përcjelljen e ekzekutimit të vendimeve të saj. Ky komitet është përbërë nga kryetari i Gjykatës, një gjyqtar, tre këshilltarë ligjorë dhe Sekretari i Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese.

Në pjesën dërrmuese të rasteve, vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë ekzekutuar nga subjektët të cilëve u ka takuar me Kushtetutë e ligj vënia në jetë e urdhrave të përmbajtur në to. Në rast të moszbatimit të një vendimi, ose të vonesës në dhënien e informacioneve për Gjykatën për masat e ndërmarra, Gjykata mund të lëshojë një aktvendim në të cilin do të theksohet që vendimi nuk është zbatuar. Ky aktvendim publikohet në Gazetën Zyrtare. Për këtë informohet Prokurori i Shtetit, thuhet në fjalinë e fundit të dispozitës së rregullit 66.8 të **RP.** Çështja mbyllet me kaq dhe përtej kësaj Gjykata nuk ka asnjë mundësi tjetër në sferën e ekzekutimit të vendimeve të saj. Si qëndron, atëherë, çështja e përgjegjësisë penale dhe përgjegjësisë tjetër, për moszbatim të vendimeve të gjykatave kushtetuese?

15.5.44. Se kur kemi të bëjmë me **res judicata** në kuptimin substancial përcaktohet me pjesën operative të vendimit, jo me pjesët tjera përbërëse: pjesa operative e vendimit e shpalosë përmbajtjen e normës kushtetuese që interpretohet me vendim të gjykatës kushtetuese. Pjesët tjera përbërëse, përveç pjesës operative, mund të konsultohen por asnjëherë nuk shërbejnë si dhënës të përgjigjes në atë se çka është **res judicata**. Kjo është shumë e qartë në vendimet që kanë të bëjnë me kontrollin e normës, abstrakt dhe konkret, si dhe me vendimet që jepen në kuadër të ushtrimit të juridiksioneve të tjera që kanë të bëjnë me kërkesat që nuk janë individuale: në këto raste arsyetimi i vendimit përbën pjesën thelbësore të verdiktit të gjykatës që shpaloset në pjesën operative. Në vendimet e dhëna në kuadër të ushtrimit (realizimit) të juridiksionit në çështjet sipas ankesave individuale, ndërkaq, **res judicata**, në parim, ka efekt një efekt tjetër dhe që është shumë më i ndryshëm se në rastet tjera. Diskutoni!

15.6. Lexim shtesë

- Patrizia Pedrezoli, *La Corte costituzionale* (Il Mulino: Bologna, 2008);
- Erin F. Delaney and Rosalind Dixon (eds.), *Comparative Judicial Review* (Edward Elgar Pub.: Cheltenham, UK, and Northampton, MA, USA, 2018);
- Erin Delaney and Rosalind Dixon, *Comparative Judicial Review* (Edward Elgar: UK & USA, 2018);
- *Arne Marjan Mavčič, P.E, editor, Constitutional Review Systems Around the World* (Vandeplas Publishjinge, LL.C.: USA, 2019).

16. MBI VENDIMET KRYESORE TË GJYKATËS KUSHTETUESE NË DEKADËN E PARË

Përgjithësisht. - Në këtë kapitull, i cili ka njëmbëdhjetë seksione, pa llogaritur seksionet standarde mbi komentet dhe pyetjet si dhe literaturën shtesë për lexim, diskutohen vendimet kryesore që kanë vënë themelet e gjyqësisë kushtetuese kosovare, ani se disa prej tyre kanë shkaktuar keqkuptime ndër laikë dhe te një pjesë e vogël e komunitetit juridik me angazhim të theksuar popullist. Qasja jonë në këtë kapitull është mjaft kritike ashtu që lexuesi mund të krijoj vetë një mendim pas leximit të plotë të vendimeve që shtjellohen dhe argumenteve të përdorura aty, duke i krahasuar të njëjtat me standardet e gjykimit në gjyqësinë kushtetuese bashkëkohore, një pjesë e të cilave janë shpalosur nëpër kapitujt e këtij libri.

Kapitulli, sikundër shihet, ka më shumë seksione se secili nga kapitujt e mëparshëm. Kjo është bërë për arsye të përzgjedhjes së mostrës përfaqësuese të vendimmarrjes në gjyqësinë kushtetuese kosovare, mostër që reflekton nivelin e kësaj gjyqësie gjatë dekadës së parë të saj. Kemi dashur që për dekadën e parë të përzgjedhim njëmbëdhjetë vendimet më të rëndësishme që kanë pasur ndikim sistemik në sundimin e ligjit dhe në juridifikimin e theksuar të proceseve politike në Kosovë, por edhe të tregojmë dallimet që ekzistojnë në standardin e gjykimit në mes të vendimeve të vetë kësaj dekade.

Këtë qasje e kemi marr duke qenë të inspiruar nga përvoja gjermane me gjyqësinë kushtetuese, jo vetëm për shkak se juridiksioni i **Gjykatës Kushtetuese** dukshëm ngjason me juridiksionin e **Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë** (**GJKGje**), rrethanë që e kemi hasur në literaturën e përdorur për prodhimin e këtij libri. Rasti gjerman merret si shembull në tërë botën e qytetëruar sepse **GJKGje**, në vitet e para të punës së saj, ka dhënë vendime që kanë zgjuar kërshërinë e komunitetit juridik dhe publikut të gjerë. Me kalimin e kohës, ato vendime kanë "fjetur" në ndërgjegjen kolektive gjermane, aq sa sot duket qesharake dhe tërësisht i pavend reagimi i komunitetit juridik dhe i publikut në kohën kur janë marrë ato.

Gjykuar sipas autorëve që kanë studiuar këtë periudhë të zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese, dy arsye kanë qëndruar prapa situatës së përshkruar si më sipër në gjyqësinë kushtetuese të këtij vendi: e para ka të bëj me mungesën e përvojës me këtë lloj gjyqësie (gjyqësia e rregullt gjermane kishte qenë thellësisht e kompromet uar gjatë kohës së sundimit nazist, në mënyrë të njëjtë siç kishte ndodhur me gjyqtarët e **ancien regime** në **Francën** e para vitit 1789, apo gjetiu në pjesën dërrmuese të vendeve në **Evropën komuniste**); arsyeja e dytë, ndërkaq, i referohet gjendjes së përgjithshme të shoqërisë gjermane pas Luftës së Dytë Botërore, përkatësisht traumave të mëdha nëpër të cilat pat kaluar kjo shoqëri gjatë regjimit nazist. Në veçanti për shkak të arsyes së dytë, por edhe për arsye të tjera, në **Gjermani** interpretimi i **Ligjit Themelor** (**LTH**) nuk bëhet me mbështetje në burimet historike dhe në historinë kushtetuese gjermane. Kjo vlen jo vetëm për **GJKGje**, por për çdo autoritet publik. Në literaturë, kjo cilësohet si konstitucionalizëm i bazuar në idenë **kurrë më** (**never again)**, me kuptim ndërprerjen e çdo kontinuiteti juridik-kushtetues, socio-politik, historik dhe kulturor me Gjermaninë e pas vitit 1933.[1] Kjo ndërprerje nuk nënkuptonte eliminimin e traditës gjermane të legalizimit, sipas së cilës e drejta mund të ekzistonte dhe të interpretohej në mënyrë të pavarur nga politika. Kjo traditë qe kompromet uar thellë gjatë kohë së **Nazizmit** dhe qe akuzuar se kishte ndihmuar ardhjen e **Hitlerit** në pushtet.

[1] Jamal Greene and Yvonne, "Comparative analysis to constitutional history." Në Erin F. Delaney and Rosalind Dixon (eds.), *Comparative Judicial Review*. (Edward Elgar Publishing: UK and USA, 2018) fq. 379-402 në fq. 387-390; Cf. edhe Steven Gow Calabresi, "The origins and growth of judicial enforcement". Në Erin F. Delaney and Rosalind Dixon (eds.), *Comparative Judicial Review*, fq. 83-97, në 90-91.

Traumat nëpër të cilat kishte kaluar shoqëria gjermane, si një faktor i jashtëm me ndikim shumë të madh, në vend se të bëheshin hendikep i progresit gjerman, ato shërbyen si një shtytje e fortë për rigjallërimin e traditave gjermane të legalizimit, për fuqinë autonome të ligjit kundrejt politikës, por tani me një dallim thelbësor: normat juridike pozitive të këtij legalizimi të ri u shndërruan në rregulla të mbushura plot me vlera që burojnë nga **Karta Gjermane e të Drejtave të Njeriut**, e mishëruar në kapitullin e parë të **LTH**. Falë këtij kapitulli dhe interpretimit të **LTH** nga ana e **GJKGje**, normat kushtetuese gjermane sot paraqesin **një rend objektiv të vlerave**, të cilat përshkojnë tërë shoqërinë gjermane, në aspektin vertikal dhe horizontal. Kjo nënkupton se normat juridike të këtij rendi objektiv kanë cilësinë e një objekti, falë vlerave që mishërohen në përmbajtjen e tyre dhe që mund të interpretohen në mënyrë ideologjikisht neutrale dhe krejtësisht jo-politike, në pajtim me traditën gjermane të kohës së legalizimit klasik.

Nuk ka dyshim që, në këtë kuptim, kjo përfaqëson një ringjallje të traditës së legalizimit sepse normat juridiko-kushtetuese gjermane kanë marr fuqi dhe jetë autonome pavarësisht fluktuimeve politike që ndodhin dhe zhvillohen përreth. Në këtë mënyrë, norma juridiko-kushtetuese gjermane ka karakter autonom, si pasojë e lyerjes së saj me vlera që ankorohen në kapitullin e **LTH** që bën fjalë mbi liritë dhe të drejtat e njeriut:[2] aktualisht, legalizimi e pozitivizmi gjerman nuk përbëjnë vetëm ideologji dhe bindje lidhur me normat juridiko-kushtetuese, të kuptuara si rregulla të sjelljes me përmbajtje të vendosur nga vullneti i përgjithshëm (**volonte generale**). Kjo është kështu sepse normat në fjalë të **LTH** kanë fituar një përmbajtje vlerore që ankorohet njëherë e mirë në pjesën e tij që bën fjalë për liritë dhe të drejtat njerëzore dhe që çdoherë mund të interpretohen ndaras nga politika.

Këtë orientim të përgjithshëm dhe këtë trajektore të lëvizjes së gjyqësisë model kushtetues të shoqërisë gjermane mëton ta ndjek Kosova dhe shumica e vendeve ish-komuniste të **Evropës**, në veçanti ato që kanë në sistemin e tyre kushtetues ankesën kushtetuese të tipit të plotë. Këtë model e kanë ndjekur **Spanja** dhe **Portugalia** pas rrënimit të diktaturave në mesin e viteve tetëdhjetë të shekullit 20-të. Përmes **Spanjës**, ky model më pas është përhapur në një pjesë bukur të madhe të vendeve të **Amerikës Latine**, për çka kemi folur në kapitujt e parë të këtij libri që diskuton historikun e gjeografisë së gjyqësisë kushtetuese.

Në vijim si më sipër dhe me qëllim të pasqyrimit të përpjekjeve të gjyqësisë kushtetuese kosovare për të lëvizur në drejtim të njëjtë me vendet ish-komuniste të Evropës, që në thelb kanë ndjekur rrugën gjermane, trembëdhjetë seksionet e këtij kapitulli janë të ndara në dy grupe: grupit të parë i takojnë gjashtë seksionet e para që flasin për periudhën e viteve formative të **GJKRKS** (2009-2015), kurse të dytit seksionet që trajtojnë vendimet nga vitet 2015 - 2019. Përzgjedhja e vendimeve ka karakter ilustrativ, sa për ti dhënë lexuesit një ide lidhur me jetën dhe punën e Gjykatës në dy periudhat e sipërcekura.

Rastet ilustrative të grupit parë janë si vijon:

- seksioni i parë, i cili diskuton rastin e njohur si **rasti i Radio Televizionit të Kosovës (RTK)**,[3] bën fjalë për një vendim që nuk ka qenë vendim meritor, por as vendim procedural mbi lejueshmërinë e kërkesës (për shqyrtim dhe vendosje meritore);
- seksioni i dytë, i titulluar si **Tregimi për dy Presidentët**, diskuton rastet e njohura të dy ish-presidentëve të Kosovës që kishin humbur pozitat e tyre si rezultat i gjetjeve të Gjykatës Kushtetuese: **rasti Sejdiu**,[4] i cili ka të bëjë me ish-Presidentin e Republikës së Kosovës, **Fat-**

[2] Theunis Roux, "Losing faith in law's autonomy: a comparative analysis". Në Erin F. Delaney and Rosalind Dixon (eds.), *Comparative Judicial Review*, fq. 204-225 në fq. 226, 220-221.

[3] *Rasti KI 11/09. Vendim. Masë e Përkohshme/MP/. Parashtrues: Tomë Krasniqi kundër RTK-së dhe të tjerëve.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë: 16 tetor 2009. Akti Nr. MP 01/09.

[4] *Rasti KI 47/10. Aktgjykim. Naim Rrustemi dhe 31 Deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës kundër Shkëlqesisë së Tij Fatmir Sejdiut, President i Republikës së Kosovës*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë: 28 shtator 2010. Ref. Nr. AGJ 43/10.

mir Sejdiu, dhe **rasti Pacolli**,[5] i cili ka të bëj me ish-Presidentin **Behxhet Pacolli**;

- seksioni i tretë trajton rastin që ka lidhje organike me dy seksionet e fundit si më sipër dhe i referohet çështjes së njohur si **rasti Jahjaga**,[6] kur është zgjedhur presidentja e parë femër e Kosovës; pas një periudhe disamuajshe politikanët provuan shkarkimin e saj përmes amendamentit kushtetues, një precedent ky i rrezikshëm që u pengua me shumë sukses nga ana e Gjykatës Kushtetuese;
- seksioni i katërt, i cili trajton marrëdhënien në mes të disa departamenteve të **Gjykatës Supreme të Kosovës** (**GJSK**) dhe **Agjensionit Kosovar të Privatizimit** (**AKP**), njihet si **rasti i AKP**[7] dhe ka për objekt kryesor trajtimin e zbatimit të Kushtetutës dhe ligjeve në tërë territorin e Kosovës si dhe zbatimin uniform të ligjit në Kosovë (roli **nomoflikatik** i instancës së fundit gjyqësore në Kosovë); këto departamente të GJSK përbëheshin nga gjyqtarë ndërkombëtar që sfidonin jo vetëm zbatimin uniform të ligjeve të Kosovës, si detyrë primare kjo e GJSK, por edhe të Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës;
- seksioni i pestë bën fjalë për rastin e njohur si **rasti VLAN;**[8] dhe
- seksioni i gjashtë dhe i fundit i grupit të parë diskuton rastin "**Banka Raiffeisen"**.[9]

Të grupit të dytë, ndërkaq, janë rastet si vijon:

- seksioni i shtatë trajton **Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe** dhe njihet se **rasti i Asociacionit Serb;**[10]
- seksioni i tetë lidhet me statusin e pronës së një manastiri serb në Kosovë dhe njihet **rasti i Manastirit të Deçanit;**[11]
- seksioni i nëntë, që nuk përbën aktgjykim meritor por që nis praktikën e përpjekjeve të Gjykatës Kushtetuese për ndryshim me aktvendim (me vendim jomeritor) të praktikës së saj gjyqësore, trajton njihet si **rasti i zgjedhjes së Presidentit H. Thaçi;**[12]

---

5 *Rasti KO 29/11. Aktgjykim. Sabri Hamiti dhe Deputetët e tjerë: Vlerësimi Kushtetues i Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 04-V-04, Përkitazi me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës të 22 shkurtit 2011*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë: 30 mars 2011. Ref. Nr.: AGJ 107/11.

6 *Rastet KO 29/12 & KO 48/12. Aktgjykim. Parashtrues: Kryetari i Kuvendit të Kosovës. Amendamentet e propozuara kushtetuese të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 20 korrik 2012. Nr. Ref.:AGJ 284/12.

7 *Rasti KI 25/10. Aktgjykim. Parashtrues: Agjencia Kosovare e Privatizimit. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC 09—89, të 4 shkurtit 2010*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë: 31 mars 2011. Nr. Ref.: AGJ 109/11.

8 Në fakt, rasti **VLAN** përfshin dy aktgjykime të Gjykatës Kushtetuese, të njohura si **VLAN I** dhe **VLAN II**: *Rasti KO 103/14. Aktgjykim. Parashtrues: Presidentja e Republikës se Kosovës. Përkitazi me vlerësimin e përputhshmërisë se nenit 84 (14) [Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverise] te Kushtetutës se Republikës se Kosovës*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë: 1 korrik 2014. Nr. Ref: AGJ 671/14. (**VLAN I**) dhe *Rasti KO 119/14. Aktgjykim. Parashtrues: Xhavit Haliti dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës Vlerësim i kushtetutshmërisë se Vendimit Nr. 05-V-001, te votuar nga 83 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Kryetarit te Kuvendit te Republikës se Kosovës, te 17 korrikut 2014.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë: 26 gusht 2014. Nr. Ref.: AGJ 700/14. (**VLAN II**).

9 *Rasti KI 118/14. Aktvendim. Parashtrues: Raiffeisen Bank Kosovo J. S. C. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 24/2013, të 5 shkurtit 2014.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtine: 9 mars 2015. Nr. ref.: RK 777/15.

10 *Rasti. K0 130/15. Aktgjykim. Parashtrues: Presidentja e Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar "Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore" me frymën e Kushtetutës, me nenin 3.1 [Barazia para Ligjit], me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, 23 dhjetor 2015. Ref. Nr.: 1877/15.

11 *Rasti KI 132/15. Aktgjykim. Parashtrues: Manastiri i Deçanit. Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë se dy vendimeve te 12 qershorit 2015, nr. AC-I-13-0008 dhe nr. AC-I-13-0009, te Kolegjit te Ankesave te Dhomës se Posaçme të Gjykatës Supreme te Republikës se Kosovës për çështje qe Lidhen me Agjencinë Kosovare te Privatizimit.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë: 20 maj 2016. Ref.: 943/16.

12 *Rasti KO 47/16. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Aida Derguti, Bali Muharremaj, Enver Hoti dhe 25 deputete të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr, 05-V-233, të 26 shkurtit 2016, për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë: 4 prill 2016. Nr. Ref.: RK 911/ 16.

- seksioni i dhjetë, i cili po ashtu nuk është vendim meritor (aktgjykim), njihet si **rasti i KQZ**[13] dhe shënon përpjekjen e serishme të Gjykatës Kushtetuese për të ndryshuar praktikën e mëparshme gjyqësore me vendim jomeritor (aktvendim);
- seksioni i njëmbëdhjetë, i cili është në lidhje organike me seksionin e dhjetë si më sipër, trajton rastin e njohur si **rasti i tentim-rrënimit të Gjykatës Speciale**;[14] këtu Gjykata Kushtetuese në mënyrë profesionalisht skandaloze dhe të papranueshme ka luajtur rolin e avokatit të Presidentit të Republikës, duke e udhëzuar të njëjtin që të rishikoj kërkesën e vet me qëllim të shndërrimit të saj në një kërkesë për konflikt kompetence me Kuvendin e Kosovës; ky konflikt për kompetencë në mes të Presidentit dhe Kuvendit ka qenë tërësisht fiktiv dhe jo ekzistent; edhe në këtë rast, Gjykata sërish me vendim jomeritor (aktvendim) provoi përligjësimin e ndryshimit arbitrar të praktikës së etabluar gjyqësore;
- seksioni i dymbëdhjetë trajton **rastet që kanë të bëjnë me përsëritjen e procedurës**, si një mjet juridik shumë i rëndësishëm në të gjitha procedurat gjyqësore në vendet perëndimore dhe në kulturat juridike që modelohen sipas këtyre vendeve, ku bën pjesë edhe Kosova, dhe si një e drejtë kushtetuese për mjet juridik efektiv, por të cilin **Gjykata Kushtetuese** e ka futur në kategorinë e fushës ndaj së cilës ajo nuk paska kompetence **ratione materiae**; ky pozicion i Gjykatës është arsyetuar, siç do të shihet gjerësisht në këtë seksion, me terma shumë të çuditshëm dhe të papranueshëm për standardet profesionale të gjyqësisë kushtetuese bashkëkohore evropiane.[15]

Sikundër me kapitujt tjerë, edhe këtu ekzistojnë dy seksionet e fundit: njëri ka të bëjë me pyetjet dhe komentet, kurse tjetri me literaturën shtesë. Për dallim nga kapitujt tjerë, megjithatë, këtu si komente e pyetje paraqiten rastet nga praktika, të cilat lexuesi duhet t'i lexoj dhe studioj për shkak se kanë lidhje organike me tërë diskutimin e tonë këtu. Përmes tyre, lexuesi mund të krijojë një pasqyrë themelore lidhur me praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese në dekadën e parë të ekzistencës së saj. Edhe këtu, vendimet janë përzgjedhur me randomizim. Ato i japim si shtesë sepse ka rëndësi që vet lexuesi, pasi ta përvetësojë lëndën me studimin e rasteve të këtij kapitulli, të bëjë një vlerësim autonom lidhur me gjendjen e praktikës së Gjykatës sot.

Rasti i parë që e rekomandojmë për lexuesin, **rasti KO 118/13**, ka të bëj me ligjin për buxhetin dhe trajton në tërësi çështjet e kushtetutshmërisë së buxhetit dhe statusin e organeve kushtetuese në procesin e miratimit të tij. Këtë rast e kemi përzgjedhur sepse tjetri rast në vijim, **rasti KO 12/18**, i njohur në publik si **rasti i rrogave**, ka të bëj me statusin kushtetues të një vendimi qeveritar për rritjen arbitrare të rrogave, të cilin, megjithatë, **Gjykata Kushtetuese** e ka gjetur si në pajtim me Kushtetutën (sic!). Kjo ka rëndësi për lexuesin sepse kushtetutshmëria e vendimeve të ekzekutivit nuk prezumohet aq fuqishëm siç ndodh kjo me ligjet dhe aktet e tjera të përgjithshme, mbi bazën e të cilëve ekzekutivi duhet dhe mund të rris dhe

---

13 *Rasti 79/ 18. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Presidenti i Republikës së Kosovës. Kërkesë për interpretim të nenit 139 paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë: 3 dhjetor 2018 Nr. ref.: RK 1294/18.

14 *Rasti KO 131/18. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Presidenti i Republikës. Kërkesa e Presidentit të Republikës për vlerësim të konfliktit në mes të kompetencave kushtetuese të Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës, siç është përcaktuar me nenin 113.3 (1) të Kushtetutës*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtinë: 25 mars 2019. Nr. ref.: RK 1339/19.

15 *Rasti KI 159/15. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Sabri Ferati. Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë se Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN. nr.499/2015, të 29 shtatorit 2015*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë: 13 qershor 2016. Nr. ref.:RK947/16; *Rastet KI 80/15, KI 81/15 dhe KI 82/15 (të bashkuara). Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Rrahim Hoxha. Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktvendimeve të Gjykatës së Apelit Ae. nr. 188/2014, 189/2014, të 19janarit 2015, dhe Aktvendimin Ae. nr. 190/2014, të 20 janarit 2015*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë: 27 dhjetor 2016. Nr. ref.:1028/16; *Rasti KI 07/17. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Pashk Mirashi Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 228/2016, te 20 tetorit 2016 dhe Aktgjykimit të Gjykatës se Apelit, PAKR nr. 231/2015, te 6 gushtit 2015.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë: 12 qershor 2017. Nr. ref.: RK 1091/17; dhe, së fundi, *Rasti KI 40/19. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Alije Shabani, Lulezim Shabani, Luljeta Shabani dhe Kujtim Shabani. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 394/2018, te 14 janarit 2019*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë: 7 tetor 2019. Nr. Ref.: RK 1440/19.

zvogëloj rrogat e veta dhe të vartësve të tij. **E thënë ndryshe, asnjëherë në demokracitë kushtetuese të sistemeve parlamentare nuk kontestohet e drejta e ekzekutivit për rritjen e rrogave, por baza juridike mbi të cilën bëhet kjo rritje**. Ajo bazë çdoherë duhet të mbështetet në një akt të përgjithshëm, zakonisht i njohur si ligji për buxhetin nacional, apo në ndonjë ligj tjetër që autorizon një masë të tillë të ekzekutivit dhe asnjëherë në një akt individual. Kjo për shkak se një veprim i tillë prek parametrat buxhetor të cilët duhen të jenë, **inter alia**, të parashikueshëm dhe të matshëm në çdo kohë, gjë që mund të bëhet vetëm me ligjin për buxhetin ose përmes ndonjë autorizimi tjetër me bazë juridike të përgjithshme. Këtë lloj arsyetimi, si ky yni këtu, afërsisht e gjejmë të derdhur ne mendimin e përbashkët mospajtues të dy gjyqtarëve kushtetues për rastin **KO 12/18**. Kjo, në fakt, është arsyeja pse e kemi dhënë si lexim shtesë mendimin mospajtues për këtë rast. Përveç kësaj, duhet thënë se ky mendim mospajtues përbën mendimin më të hollë dhe më profesional që ka dhënë dikush në Gjykatën Kushtetuese deri në momentin e shkrimit të këtyre rreshtave (shkurt 2020), gjithnjë sipas njohurive më të mira që kanë autorët e këtij libri. Në çdo përsëritje të situatës së njëjtë, apo afërsisht të njëjtë me këtë të **rastit të rrogave**, besojmë fuqishëm se mendimi mospajtues si më sipër ishte dashur të konvertohet (shndërrohet) në mendim të shumicës, si një zgjidhje e arsyeshme dhe më afër parametrave kushtetues për vlerësimin e legjitimitetit kushtetues të vendimeve individuale të ekzekutivit kosovar që kanë efekte të mëdha buxhetore.

Dy rastet e fundit kanë të bëjnë me **rastet KI 146/17, KI 147/17, KI 148/17, KI 149/17 dhe KI 150/17**, të njohura si **Drenica I**, dhe **rastet KI 176/18, KI 183/18 dhe KI 06/19**, të njohura si **rasti Drenica II**. Në rastin e parë kemi të bëjmë me aktgjykim, kurse në të dytin me aktvendim për papranueshmëri: Gjykata Kushtetuese herën e parë ua ka dhënë të drejtën parashtruesve, kurse në të dytin ka vepruar krejt kundër vendimit të saj të parë. Ka rëndësi që vetë lexuesi të shoh arsyetimin e dytë, nivelin e tij profesional dhe ta krahasoj me rastin e parë.

16.1. Rasti i RTK

Struktura e argumenteve kushtetuese me një rresht që ka natyrë përfundimtare (që e mbyllë argumentin e parashtruar me qëllim të vërtetimit të fakteve kushtetuese), i njohur ndryshe si **rrathët lidhës zinxhiror**", e dominon narrativin e këtij vendimi. Kjo strukturë, siç e kemi theksuar në kapitullin paraprak, seksioni **15. 3** të kapitullit të pesëmbëdhjetë, karakterizohet nga një seri premisash dhe përfundimesh të ndërvarura që formojnë një argument të qëndrueshëm në vetvete, në një mënyrë të pavarur.

Kjo është e natyrshme për dy arsye: e para, sepse ka qenë rasti parë i vendimmarrjes në Gjykatën Kushtetuese; dhe, e dyta, sepse vetë forma dhe përmbajtja e vendimit ka pasur ndikim në formësimin e sjelljes së menaxhmentit të **RTK** në raport me metodologjinë e financimit të **RTK**-së si subjekt publik i transmetimit. Siç do të shohim, vendimi i Gjykatës nuk ishte aktgjykim por aktvendim me të cilën vendosej masa e përkohshme të cilën e kishte kërkuar një shtetas kosovar, masë me të cilën u ndalua inkasimi i mëtejmë i 3.5 eurove nga **RTK**-ja për të financuar aktivitetet e saj.

Rasti i **RTK** është vendimi i parë që e ka nxjerrë Gjykata më 16 tetor 2009. Ky vendim kishte të bënte me masë të përkohshme e jo me meritat e rastit. Në fakt kurrë nuk u vendos për meritat e rastit pasi që rasti u rregullua vetvetiu me kalimin e kohës. Ky vendim, megjithatë, ka pasur ndikim në vendimin për meritat e rastit.

Kërkesa njihet ndryshe edhe si rasti **KI 11/09** (**Tomë Krasniqi kundër RTK-së dhe të tjerëve**) dhe është e bazuar në një ankesë individuale të parashtruar në Gjykatë nga z. Tomë Krasniqi, një qytetar pensionist i Kosovës më 2 shtator 2009, me të cilën kërkonte nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme në lidhje me kërkesën e tij, e cila ka pasur të bëjë ndalimin e pagesës prej 3.5 eurove në muaj në emër të kërkesës të shërbimit të parapagimit për RTK.[16] Kjo shumë prej 3.5 eurosh merrej prej tij dhe të gjithë konsumatorëve të energjisë elektrike në Kosovë prej vitit 2003 deri më 16 tetor 2009, që është data e vendosjes së masës së përkohshme nga ana e Gjykatës.

[16] Cf. Paragrafi 5 i Vendimit në rastin **KI 11/09**.

Gjykata në këtë rast ka vërejtur faktin se **Korporata Energjetike e Kosovës** (**KEK**), e cila bënte inkasimin e tre euro e gjysmë (3.5) në emër të **RTK**-së, kishte pasur humbje materiale dhe dëme si pasojë e këtij inkasimi të pavullnetshëm. Këtë shumë prej 3.5 eurosh e paguanin konsumatorët e energjisë elektrike së bashku me faturat e rrymës.[17]

Gjykata e ka bërë të qartë se kërkesa për masë të përkohshme nga z. Tomë Krasniqi nuk ishte një **actio popularis**, siç mund të duket në shikim të parë, duke argumentuar se miratimi i kërkesës për masë të përkohshme praktikisht do të thoshte se do të ndalohej pagesa e mëtutjeshme e tre euro e gjysmë (3.5) euro deri sa të merrej vendimi përfundimtar për meritat e rastit. Ky veprim i Gjykatës u mbështet në mbrojtjen e interesit publik të qytetarëve të Kosovës.[18] Me një vendim të tillë, Gjykata efektivisht pezulloi zbatimin e mëtutjeshëm të nenit 20.1 të Ligjit nr. 02/L-47 për Radiotelevizionin e Kosovës të 20 janarit 2006, duke rekomanduar Kuvendit të Kosovës që "…deri në dhjetor 2009 të rishikojë natyrën e nenit 20.1 të Ligjit për RTK-në".[19] Kuvendi pas këtij rekomandimi i rishikoi këto dispozita gjatë vitit 2010 ashtu që deri në fund të atij viti çështja u bë pa objekt shqyrtimi kështu që Gjykata përfundimisht e hoqi rastin nga lista dhe e mbylli çështjen me efekt përfundimtar.[20]

16.2.Tregimi për dy Presidentët

Mes shtatorit 2010 dhe marsit 2011, **Gjykata Kushtetuese** vendosi për fatin e dy presidentëve të Kosovës. Aktgjykimet që vendosën këtë fat, njëri më 28 shtator 2010 dhe tjetri më 30 mars 2011, dëshmuan të jenë vendimet që patën ndikimin më të madh në jetën institucionale të Kosovës. Që nga marsi 2011 ka pasur një debat të vazhdueshëm dhe janë ndërmarrë veprime të ndryshme në skenën politike kosovare me qëllim të ndryshimit të dispozitave të Kushtetutës, përkitazi me zgjedhjen dhe kompetencat e Presidentit të Kosovës.

Në rastin e parë, rasti **KI 47/10**, parashtruesit e kërkesës, 32 deputetë të Kuvendit të Kosovës, më 25 qershor 2010 i parashtruan kërkesën Gjykatës, me pretendimin se presidenti **Fatmir Sejdiu** ishte duke kryer shkelje serioze të nenit 88.2 të Kushtetutës, me mbajtjen e postit së Presidentit Kosovës dhe, gjithnjë sipas tyre, të postit të Kryetarit të partisë **Lidhja Demokratike të Kosovës** (**LDK**), atëkohë njëra nga dy partnerët e koalicionit qeverisës. Çështja kryesore, thelbi i aktgjykimit që duhej të nxirrte Gjykata, kishte të bënte me atë nëse kishte dallim ligjor mes "ushtrimit" dhe "ngrirjes" së funksionit publik, meqë Presidenti **Fatmir Sejdiu** pohonte se nuk ishte duke ushtruar funksionin e tij si udhëheqës i partisë së tij, **LDK**, që nga 28 dhjetori 2006, data kur ai kishte bërë të ditur vendimin tij për të "ngrirë" ushtrimin e funksionit të kryetarit të **LDK**.[21]

Parashtruesit e kërkesës, ndërkaq, pretendonin se neni 88 i Kushtetutës nuk flet për "ngrirje", gjë që nënkuptonte se mbajtja e dy posteve nga presidenti i Kosovës, **Fatmir Sejdiu**, paraqiste shkelje serioze të Kushtetutës, siç parashihet me nenin 88.2 në lidhje me nenin 83 të Kushtetutës.[22]

---

17 Cf. Paragrafi 11 i Vendimit në rastin **KI 11/09**..

18 Paragrafët 13 dhe 17 të Vendimit në rastin **KI 11/09**.

19 Pjesa operative pika II e Vendimit në rastin **KI 11/09**.

20 Dy **mendime mospajtuese** u paraqitën nga dy gjyqtarë, diçka e paprecedent në historinë e gjyqësisë kushtetuese sepse u bë "atakimi" i një vendimi për masë të përkohshme. Është vendimi përfundimtar për meritat (gjë që kurrë nuk ka ekzistuar në këtë rast), ai ndaj të cilit mund të paraqitet mospajtimi dhe mendimi konkurruese. Ajo çfarë bënë këta dy gjyqtarë duke paraqitur mendim mospajtues ndaj një urdhri për lejimin e masës së përkohshme në esencë përfaqëson mendimin e tyre për meritat e rastit. Në procedura normale të çdo gjykate, një veprim i tillë i këtyre dy gjyqtarëve do të paraqiste bazë absolute për përjashtimin e tyre nga këshillimet e mëtejmë për rastin. Pasi që për meritat e rastit kurrë nuk u mor vendim u bë një zgjidhje për ruajtjen e nderit të tyre kështu që Gjykatës nuk i është dashur të gjendet në pozitë të tillë që të detyronte të dy gjyqtarët të largoheshin gjatë fazës së këshillimeve. Cf. *Rasti KI 11/09, Tomë Krasniqi kundër RTK-së dhe KEK-ut. Mendimi mospajtues: gjyqtari Almiro Rodrigues, në lidhje me masën e përkohshme*; dhe *Rasti KI 11/09, Tomë Krasniqi kundër RTK-së dhe KEK-ut. Mendimi mospajtues: gjyqtarja Gjyljeta Mushkolaj, në lidhje me masën e përkohshme*. fq. 16-36.

21 Paragrafi 21 i Aktgjykimit në rastin **KI 47/10.**

22 Paragrafët 11-16 e Aktgjykimit në rastin **KI 47/10**. Neni 88. 2 [Papajtueshmëria] i Kushtetutës thotë se "[…] Pas zgjedhjes, Presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion në parti politike", përderisa neni 83 [Statusi i Presidentit] i Kushtetutës sanksionin statusin e Presidentit ashtu që ai/ajo "[...] është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës".

Pas parashtrimit të kërkesës, nënshkruar nga 31 deputetë, tre prej tyre u tërhoqën.[23] Sipas mendimit të përfaqësuesve ligjorë të presidentit **Fatmir Sejdiu**, kjo tërheqje e tyre e bënte kërkesën të papranueshme **ipso facto** sepse, siç thanë ata, duhej të ishin së paku 30 deputetë të cilët, gjatë gjithë kohës dhe brenda tridhjetë (30) ditësh kontestojnë kushtetutshmërinë e veprimeve të Presidentit të Republikës.[24]

Gjykata, më 22 shtator 2010, shqyrtoi me dyer të mbyllura kërkesën, duke vendosur për pranueshmërinë dhe meritat e saj. Sa i përket pranueshmërisë, Gjykata deklaroi se çështja "i është referuar në mënyrë të ligjshme nga pala e autorizuar", pavarësisht tërheqjen e tre deputetëve nga rasti.[25] Kjo do të thotë se Gjykata mori qëndrim se momenti i referimit të çështjes asaj është momenti që përcakton faktin nëse një parashtrues është palë e autorizuar apo jo. Për më tepër, Gjykata vërejti se edhe pas tërheqjes së palës ajo prapë mund të veprojë lidhur me kërkesën. Sa i përket afatit prej 30 ditësh nga shkelja siç parashihet me Kushtetutë, Gjykata konsideroi se shkelja e pretenduar paraqet një situatë të vazhdueshme meqë presidenti i Kosovës, **Fatmir Sejdiu**, mbante këto dy poste, atë të kryetarit të LDK dhe presidentit të Republikës së Kosovës, madje edhe gjatë tërë kohës sa ishte paraqitur kërkesa në Gjykatë (nga 28 dhjetori 2006 deri më 25 qershor 2010).

Për meritat e rastit, Gjykata gjeti se kishte shkelje të nenit 88.2 të Kushtetutës, si rezultat i faktit të mbajtjes së dy funksioneve të cekura, duke arsyetuar se nuk është e mundur të "ngrihet" një funksion partiak siç pretendohej nga Presidenti **Fatmir Sejdiu**. Për më tepër, Gjykata vendosi se, meqë Presidenti dhe partia e tij, **LDK**, "përfitojnë nga asocimi me njëri tjetrin",[26] kjo praktikisht do të thotë se ai ushtroi funksionin e tij si udhëheqës partie përderisa njëkohësisht ishte President i Republikës së Kosovës. Ky fakt i vetëm përbën shkelje serioze të Kushtetutës së Kosovës, tha Gjykata, gjegjësisht shkelje të nenit 88.2, duke mbajtur njëkohësisht postin e Presidentit të Republikës dhe atë të Presidentit të **LDK**.[27]

Dy mendime mospajtuese u paraqitën në këtë rast, respektivisht nga gjyqtarët **Snezhana Botusharova** dhe **Almiro Rodrigues**.[28] Pikat kyçe të mospajtimeve trajtuan me sa vijon: çështjen e palës së autorizuar, afatet kohore për parashtrimin e kërkesës në raste të tilla, mbështetja e kërkesës dhe, përfundimisht çështja e përdorimit të **travux preparatoires** (punëve përgatitore) të Kushtetutës së Kosovës kur vendoset për këtë çështje.

Sa i përket palës së autorizuar, mospajtuesit argumentuan se meqë tre (3) nga tridhjetenjë (31) deputetët tërhoqën pajtimin e tyre me kërkesën e 25 qershorit 2010, rasti u bë i papranueshëm meqë "[…] është e nevojshme që të njëjtit parashtrues të kërkesës të mbeten deri në fund të procedurës."[29] Për më tepër, mospajtuesit argumentuan se jo vetëm personat, por edhe "*petitumi dhe arsyet për petitum*" duhet të ngelin, siç e thonë ata, "stabil" që nga njoftimi i palëve kundërshtare për rastin derisa të merret vendimi përfundimtar për rastin.[30] Me

---

23 Paragrafi 7 i Aktgjykimit në rastin **KI 47/10**.

24 Paragrafët 17-29 e Aktgjykimit në rastin **KI 47/10**. Cf. edhe këto dispozita kushtetuese e ligjore: neni 113.6 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës: "Tridhjetë (30) ose më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës janë të autorizuar të referojnë pyetjen nëse Presidenti i Republikës së Kosovës ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës"; dhe neni 45 [Afatet] i **Ligjit Nr. 03/L-121** për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (**Ligji Nr. 03/L-121**): "Kërkesa duhet të parashtrohet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve që nga dita kur shkelja e pretenduar kushtetuese nga ana e Presidentit është bërë publike".

25 Cf. Paragrafët 30-47 të Aktgjykimit në rastin **KI 47/10**.

26 Cf. paragrafi 68 i Aktgjykimit në rastin **KI 47/10**.

27 Cf. Pjesa operative pika II e Aktgjykimit.

28 **Mendim i Përbashkët Mospajtues** i gjyqtarit **Almiro Rodrigues** dhe gjyqtares **Snezhana Botusharova**: *Rasti Nr. KI 47/10 Naim Rrustemi dhe 31 Deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kundër Shkëlqesisë së Tij, Fatmir Sejdiu, President i Republikës së Kosovës* (12 tetor 2010).

29 Cf. Paragrafi 10 i **Mendimit të Përbashkët Mospajtues.**

30 Cf. Paragrafi 10 i **Mendimit të Përbashkët Mospajtues.**

këtë qëndrim, dy gjyqtarët mospajtues krejtësisht injoruan, apo harruan, dispozitat e **Ligji nr. 03/L-121** [31]dhe të **Rregullores së Punës së Gjykatës (RP)**,[32] që i japin diskrecion të qartë Gjykatës për të vendosur për kërkesën e parashtruar edhe nëse parashtruesi tërhiqet.

Sa i përket afatit kohor prej tridhjetë (30) ditësh për parashtrimin e kërkesës në Gjykatë në rastet e shkeljeve serioze të Kushtetutës nga Presidenti i Republikës, mospajtuesit me të drejtë vërejtën se "[…] qëllimi i këtij rregulli është që njëkohësisht të ndalojë autoritetet, dhe persona të tjerë të interesuar, që të mos mbahen në gjendje pasigurie për një kohë të gjatë". Ata janë plotësisht gabim, megjithatë, kur kontestojnë mendimin e shumicës e cila pranoi se Presidenti i Kosovës **Fatmir Sejdiu** ishte duke shkelur Kushtetutën që nga momenti kur u bë udhëheqës i shtetit pa braktisur postin e tij si udhëheqës i **LDK**, por, në vend të kësaj, zgjodhi të "ngrijë" atë. Mospajtuesit argumentuan se afati prej tridhjetë (30) ditësh ka kaluar kohë më parë dhe se tridhjetë e dy (32) deputetët nuk kishin të drejtë të parashtronin kërkesës ngase nuk kishte "shkelje të vazhdueshme" të Kushtetutës siç deklaroi shumica, sepse "[...] ky koncept ka të bëjë me situata që janë të vazhdueshme për shkak të mungesës së një mjeti efektiv të brendshëm, i cili mund t'i japë fund atyre ose sepse mjetet ekzistuese nuk janë më efektive".[33] Gjyqtarët mospajtues nuk thonë asgjë lidhur me atë se cilat mjete vendore ishin të disponueshme dhe për kë, si dhe nëse mjetet, nëse ka, kanë qenë të efektshme. Mjete të tilla nuk ekzistojnë në rendin kushtetues të Kosovës sa i përket Presidentit të Republikës. Në fakt, asnjë procedurë e mirëfilltë për denoncim (të Presidentit) nuk ekziston në Kosovë, e cila do të mund të ngrihej në mënyrë autonome (të pavarur) kundër Presidentit pa vendim paraprak të nxjerrë nga Gjykata Kushtetuese.

Çështja e ngritur në mospajtim ka të bëjë me mbështetjen me prova të kërkesës. Janë dy gjëra që ndahen aty. E para, mospajtuesit argumentojnë se kërkesa ishte qartazi e pabazuar, për shkak të mungesës së dëshmive bindëse në mbështetje të shkeljes së pretenduar. Kjo do të thotë se, sipas mospajtuesve, parashtruesit e kërkesës do të duhej të dëshmonin se shkeljet serioze të Kushtetutës ishin kryer nga Presidenti në mënyra të ndryshme. Megjithatë, vetë mospajtuesit nuk thonë asgjë për llojin e provave që do të duheshin paraqitur nga parashtruesit e kërkesës. E gjitha që thonë ata në paragrafët 31 dhe 32 mospajtimit të tyre është një elaborim **in abstracto** i praktikës gjyqësore të **Strasburgut**, pa ndonjë kontekst konkret në lidhje me rastin në diskutim. E njëjta vlen edhe për të dytën, çështjen e ngritur për meritat e rastit, kjo është, shkelja e parimeve gjyqësore dhe barazia e armëve të Presidentit të Republikës, sepse, siç thonë ata, nuk kishte fare procedura verbale dhe se argumentet e palës kundërshtare, Presidenti i Republikës, do të duhej t'ju ishin komunikuar edhe parashtruesve të kërkesës për komente, ose, edhe mund të ishin diskutuar në seancë publike. Në mbështetje të mendimeve të veta, mospajtuesit cituan nenin 55 të **Ligjit e Gjermanisë për GJKGje**, duke trajtuar procedurën e denoncimit të Presidentit Federal.[34] Kjo është, siç u vërejt, një pikëpamje plotësisht e gabuar, ngase në rendin kushtetues të Kosovës nuk ekziston procedura e denoncimit të Presidentit si e vetme dhe e ndarë nga vendimi paraprak i Gjykatës Kushtetuese që do të konfirmonte shkeljet serioze të Kushtetutës nga Presidenti i Republikës. Një procedurë e tillë ekziston në **Shqipëri**, **Rumani** dhe në disa vende të tjera,

---

31 Neni 23 [Tërheqja e palës] i **Ligjit Nr. 03/L-121**: "Gjykata Kushtetuese do të vendosë për çështjet që u janë referuar në mënyrë ligjore nga ana e palëve të autorizuara pavarësisht tërheqjes së palës nga procedura."

32 Rregulli 32 [Tërheqja e kërkesës] i **RP**: "[...] (1) Pala e cila ka parashtruar kërkesën mund ta tërheq atë në çfarëdo kohe para fillimit të seancës dëgjimore për atë kërkesë; (2) Pavarësisht tërheqjes në pajtim me paragrafin (1), Gjykata mund të zgjedh të vendos në lidhje me atë kërkesë. Në rast të tillë, Gjykata vendos pa seancë dëgjimore, duke u bazuar vetëm në kërkesë dhe përgjigje, në rast se përgjigja është parashtruar, dhe çfarëdo dokumentesh të bashkëngjitura asaj;
(3) Sekretariati njofton të gjitha palët me shkrim për tërheqjen e palës dhe përcaktimin e Gjykatës për të vendosur në bazë të kërkesës pavarësisht tërheqjes së saj".

33 Cf. Paragrafi 21 i **Mendimit të Përbashkët Mospajtues**.

34 Cf. Paragrafët 31-34 të **Mendimit të Përbashkët Mospajtues**.

ku parlamenti luan rolin e denoncuesit.[35] Në Kosovë nuk ekziston një denoncues i tillë i vetëm dhe i ndarë nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese. Për më tepër, si rregull, procedurat në **Gjykatën Kushtetuese** janë me shkrim, përderisa dëgjimet verbale janë një përjashtim për rastet kur Gjykata vlerëson se ato do t'i kontribuonin aspektit ligjor dhe faktik të trajtimit të një kërkese. Kjo është një rregull i përgjithshëm në të gjitha gjykatat kushtetuese të Evropës, dhe gjetkë.[36]

Për më tepër, sa i përket gabimit lidhur me argumentin e denoncimit, argumenti i mospajtuesve se komunikimet dhe njoftimet e Presidentit si palë kundërshtare do të duhej dërguar parashtruesve të kërkesës po ashtu është e një natyre të dyshimtë. Kjo për shkakun se po të veprohej ashtu kjo do ta bënte edhe më të vështirë pozitën e Presidentit dhe, me siguri se, do të shkelte parimin e drejtësisë dhe barazisë së armëve, krejtësisht ndryshe nga ajo që argumentojnë mospajtuesit në mënyrë jo dhe aq bindëse. Barra e dëshmimit të mëtutjeshëm do të kishte rënë mbi palën kundërshtare, shkelës i pretenduar i Kushtetutës. Që të dyja, si dëgjimi verbal ashtu edhe komunikimi i vazhdueshëm i përgjigjeve të Presidentit do të dukeshin, sipas të gjitha gjasave, si një maskaradë dhe tregim i forcës nga ana e Gjykatës.

E njëjta si më lartë vlen edhe për argumentet e mospajtuesve lidhur me mos përdorimin e **travaux preparatoires** nga ana e Gjykatës, përderisa vendosej për meritat e rastit. Mospajtuesit kanë pasur shumë të drejtë kur kanë theksuar se ato "[...] mund të përdoren për të ndihmuar në zgjedhjen e paqartësive në tekst, për të konfirmuar domethënien atribuuar nga përdorimi i rregullave të tjera ose për t'i ikur një absurditeti".[37] Duhet cekur se, megjithatë, Gjykata gjatë punës procedurale për këtë kërkesë ka kërkuar nga **Kuvendi i Kosovës**, por edhe vetë ka hulumtuar rreth fatit të **travaux preparatoires** të Kushtetutës, por nuk i ka gjetur ato asnjëherë. Ato nuk ekzistojnë fare! Në fakt, ato mund të ekzistojnë nëpër sirtarë të ndonjë arkivi apo dosje personale, por nuk kanë vlerë provuese. Për të pasur një vlerë të tillë, ato duhet të jenë të miratuara nga prodhuesi i tyre, Kuvendi i Kosovës dhe komisionet përkatëse që kanë marrë pjesë në draftimin e tyre, ndryshe nuk kanë asnjë vlerë për një gjykim kushtetues. Mund të shtrohet pyetja se çfarë do të ishte rezultati sikur të ekzistonin **travaux preparatoires** për nenin 88 ["Papajtueshmëria"] të Kushtetutës? Përsëri duket theksuar se dokumentet e tilla do të kishin pasur ndikim negativ në pozitën e Presidentit para Gjykatës sepse pak ka gjasë që ato të pohonin se Presidenti ka pasur të drejtë të mbaj dy pozita në të njëjtën kohë. Në një demokraci kushtetuese parlamentare, shefi i shtetit çdoherë duhet të jetë jo-partizan dhe nuk mund të mbaj poste dhe funksione politike sepse ato përbëjnë konflikt interesi ngaqë janë në kundërshtim me rolin e tij/saj neutral në çështjet politike.

Dy shënime shtesë janë me vend këtu. E para, pala kundërshtare, megjithatë, nuk ka kërkuar kurrë nga Gjykata që t'i përdorte **travaux preparatoires** lidhur me nenin 88 të Kushtetutës:

---

35 Për rastin shqiptar, Cf. mendimin e **Komisionit të Venecias** në të cilin në mënyrë krahasimore jepen shtjellimet elokuente lidhur me rolin dhe pozitën e shefit të shtetit në **Shqipëri**: European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Albania. Draft Opinion on the Powers of the President to Set Dates of Elections in a Parliamentary System*. **Strasbourg**, 29 September 2019 Opinion No. 959 / 2019 CDL(2019)027. Or. Engl. Paragrafët: 26-50; Për rastin shqiptar, cf. shtjellimin e gjerë të rolit dhe pozitës së **Presiendtit të Rumanisë**, si dhe vendimin e **Gjykatës Kushtetuese të Rumanisë** për (mos) shkarkimin e shefit rumun të shtetit, në Vlad Perju, "The Romanian double executive and the 2012 constitutional crisis". *International Journal of Constitutional Law*, Volume 13, Issue 1, (January 2015) fq. 246–278 në fq. 254, 259-265; Për rastin rumun, Cf. edhe "Advisory Opinion no. 1 of 6 July 2012 of the Constitutional Court, concerning the proposal to suspend from office the President of Romania, Mr. Traian Băsescu"; dhe "Ruling no. 6 of 21 August 2012 on the compliance with the procedure for the organization and conduct of the national referendum of 29 July 2012 for the dismissal of the President of Romania, Mr. Traian Basescu, and on the confirmation of its results." Në European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Constitutioanl Issues in Romania. Decisions, Rulings and Opinions of the Constitutional Court (*Translations from Romanian provided by the Romanian Authorities*).* **Opinion 685/2012. CDL-REF(2012)031** (Engl. only). **Strasbourg**, 5 September 2012, fq. 3-21; 93-100.

36 Cf. më shumë për këtë në trajtimet si vijon: Wojciech Sadurski, "Constitutional Justice, East and West: An Introduction". Në Wojciech Sadurski (ed), *Constitutional Justice, East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective* (Kluwer Law International: The Hague, 2002) fq. 1-18; John Ferejohn and Pasquale Pasquino,, "Constitutional Courts as Deliberative Institutions: Towards an Institutional Theory of Constitutional Justice". Në Wojciech Sadurski (ed), *Constitutional Justice, East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective*, fq. 21-36.

37 Cf. Paragrafi 42 i **Mendimit të Përbashkët Mospajtues**.

asnjëherë në procedurat para Gjykatës nuk është ngritur argumenti i tillë nga ana e ish-Presidentit **Fatmir Sejdiu** apo përfaqësuesve të tij në procedurë (sic!).[38] Kjo do të thotë se çfarëdo hapi zyrtar që do të kishte ndërmarrë Gjykata më qëllim të vlerësimit të validitetit të **travaux preparatoires** nga neni 88 i Kushtetutës do të ishte një veprim **ultra vires**. E dyta, disa ditë pas vendimit të Gjykatës, pala kundërshtare, Presidenti i Republikës, **Fatmir Sejdiu**, dha dorëheqje nga zyra e kreut të shtetit. Vetëm pas dorëheqjes, ai filloi të argumentonte se ishte një marrëveshje e "pashkruar" mes tij dhe disa faktorëve ndërkombëtar që i lejonte atij imponimin e futjes së dispozitës së tanishme të nenit 84 ["Kompetencat e Presidentit"] të Kushtetutës në mënyrë që t'i mundësonte atij ushtrimin e dy pozitave dhe, njëkohësisht, t'i jepte të drejtën për të "ngrirë" pozitën e tij si udhëheqës i LDK-së, kështu që, të vazhdonte me ushtrimin e funksionit si President i Republikës ës Kosovës.[39] Edhe sikur të kishte pasur një marrëveshje të tillë mes Presidentit dhe disa faktorëve ndërkombëtar, nuk do të ndryshonte asgjë. Kjo është kështu për shkak se Gjykata nuk mund të marrë parasysh ndonjë argument ekstra kushtetues: Kushtetuta dhe asgjë tjetër, shërben si pike referimi për Gjykatën kur vendos për rastet e paraqitura para saj për vendosje në mënyrën e paraparë ligjore.

Në rastin e dytë, **rasti Nr. 29/11**, i 30 marsit 2011, në kuptimin strikt të fjalës, Gjykata nuk ka vlerësuar veprimet (ose sjelljen) e Presidentit të Kosovës, **Behxhet Pacolli**. Këtu më shumë bëhet fjalë për veprimet ose sjelljen e Kuvendit të Kosovës dhe anëtarëve të tij gjatë procedurës së zgjedhjes së Presidentit të Republikës më datën 22 shkurt 2011.[40] Një ditë më parë, kryetari i Kuvendit të Kosovës kishte ftuar deputetët për një seancë të jashtëzakonshme për ditën e nesërme. Agjenda për këtë seancë ka pasur të bëj me zgjedhjen e Presidentit të ri, pas dorëheqjes së Presidentit paraprak, **Fatmir Sejdiu**. I vetmi kandidat i propozuar për këtë zyrë ishte **Behxhet Pacolli**. Gjatë votimit, i cili ndodhi më 22 shkurt 2011, tri partitë opozitare, **LDK** (Lidhja Demokratike e Kosovës), **AAK** (Aleanca për ardhmërinë e Kosovës) dhe **VV** ("Vetëvendosja") nuk morën pjesë, ashtu që numri i atyre që morën pjesë në proces ishte gjashtëdhjeteshtatë (67) nga njëqind e njëzet (120) deputetët dhe me një kandidat të vetëm, **Kuvendi i Kosovës** pas rundit të tretë zgjodhi **Behxhet Pacollin** si president të Republikës.

Brenda tetë ditësh, më 1 mars 2011, **Sabri Hamiti** dhe 33 deputetë të tjerë, parashtruan kërkesë në Gjykatë me të cilën kontestuan kushtetutshmërinë e procedurës për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës të kryer në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit mbajtur më 22 shkurt 2011. Kërkuesit pretenduan se kishte pasur shkelje të nenit 86 [Zgjedhja e Presidentit] të Kushtetutës. Në veçanti, ata pohuan se neni 86, paragrafët 4, 5 dhe 6 të Kushtetutës ishin shkelur, në kuptim të mungesës së kuorumit të nevojshëm gjatë votimit, mungesës së kandidatit kundërshtar si dhe ndërprerjes së votimit gjatë procedurës zgjedhore.[41]

---

38 Cf. Paragrafët 17-29 të **Mendimit të Përbashkët Mospajtues**.

39 Presidenti i Kosovës **Fatmir Sejdiu** ka dhënë dorëheqje më 27 shtator 2010. Vetëm pas dorëheqjes ai ka argumentuar publikisht për ekzistimin e një marrëveshje politike në mes tij dhe faktorëve tjerë (vendas dhe ndërkombëtarë) në mbështetje të "ngrirjes" së pozitës së tij si kryetar i partisë. Ai ka argumentuar se, përveç kësaj, kjo marrëveshje (e pretenduar) ka shërbyer si kopje rezervë për **travaux preparatoires**, kjo do të thotë se ajo ka shërbyer si shtyllë për draftimin dhe formën aktuale të nenit 84 të Kushtetutës. Cf. Enver Robelli, "Doli prej zarfit, tash nuk del prej zyrës!" **KOHA DITORE**, Prishtinë, e martë, 10 korrik 2012 fq. 10. Në këtë artikull, autori përmend bindjen e fortë të ish Presidentit për ekzistimin e marrëveshjes së lartcekur "gojore" në mes tij dhe faktorëve tjerë ndërkombëtarë.

40 Sipas nenit 86 ["Zgjedhja e Presidentit"] të Kushtetutës së Kosovës, **Presidenti i Republikës** zgjedhet nga Kuvendi. Kjo përbën një përjashtim në mesin e vendeve ish-komuniste, në të cilat zgjedhja indirekte e presidentëve ka qenë mjaft i rrallë. Zgjedhja direkte e kreut të shtetit në këto vende ka qenë pjesë e përpjekjeve për të kontrolluar levat kryesore të pushtetit dhe ka paraqitur tendencën e përgjithshme të kohës për rritjen e diktaturave përbrenda tyre. Si rezultat i kësaj tendence dhe praktike, shefi i shtetit në këto vende nuk ka mundur të luajë rolin e garantuesit të stabilitetit institucional dhe ndarjes së pushteteve, përkatësisht të shërbejë si një "pushteti neutral" (bipartizan) me qëllim të promovimit dhe zhvillimit të identitetit të ri kushtetues dhe të kushtetutshmërisë në vendet ish-komuniste të Europës Juglindore. Cf. më shumë për këtë shih përmbledhjen e eseve: Anton Bebler dhe Jim Seroka (eds.), *Contemporary Political Systems: Classifications and Typologies* (Lynne Reinner Botues: Boulder and London, 1990); Arend Lijphart (ed), Parliamentary versus Presidential Government (Oxford University Press: Oxford, 1992).

41 Cf. Paragrafët 23-38 të Aktgjykimit në rastin **KO 29/11.**

Gjykata, pasi që ka shpallur kërkesën të pranueshme në baza formale,[42] është lëshuar në analizimin e meritave në mënyrë të veçantë. Me metodën e krahasimit dhe duke përdorur argumentet **këmbët e karriges**[43], Gjykata me të drejtë gjeti se kishte shkelje të nenit 86, jo për shkak të kuorumit, i cili ishte një çështje tjetër, por për shkak të faktit se në dy rundet e para është e nevojshme që dy të tretat e deputetëve të marrin pjesë me rastin e votimit dhe se duhej të kishte pasur më shumë se një kandidat për president të Republikës. Duke shkuar me vetëm një kandidat në të tri fazat e procesit dhe me vetëm gjashtëdhjetë e shtatë (67) deputetë të pranishëm dhe duke votuar, Gjykata gjeti se Kuvendi kishte shkelur jo vetëm nenin 86 të Kushtetutës por edhe frymën dhe natyrën e dispozitave që rregullojnë pozitën dhe rolin e Presidentit të Republikës si përfaqësues i unitetit (kushtetues) të njerëzve (popullit). Gjykata në njëfarë mënyre pranoi se dispozita kushtetuese për shumicën e dy të tretave (2/3) ka për qëllim kompensimin e legjitimitetit që zgjedhja e drejtpërdrejtë krijon për Presidentin e zgjedhur. E thënë me fjalë të tjera, kërkesa kushtetuese për arritjen e një shumice aq të kualifikuar (e lartë për t'u arritur) në kushtet e një konkurrence në mes të (së paku) dy kandidatëve për president Republike, ka për qëllim që fituesin eventual të garës ta veshë me legjitimitet që më së afërmi reflekton vullnetin e shumicës së qytetarëve të Kosovës. Ky argumentin ndiqte logjikën argumentuese të **Komisionit të Venecias** në njërin prej mendimeve të tij për rolin dhe pozitën e shefit të shtetit në një demokraci kushtetuese parlamentare. Esenca e rolit të shefit të shtetit në një demokraci kushtetuese parlamentare, e ka thënë Komisioni në njërin prej opinioneve të tij, është të qëndroj mbi politikën dhe të mos ndjek politikat partizane: **nuk është shefi i shtetit zyrtari më i lartë në vend për shkak se është më i fuqishmi, por sepse ajo/ai supozohet se ndjek politikat nacionale maksimalisht konsensuale duke shërbyer si kreu i shtetit dhe përfaqësues i unitetit të popullit**.[44]

Ky, megjithatë, nuk ishte mendimi i dy gjyqtarëve mospajtues në këtë rast, të cilët e cilësuan vendimin e shumicës si të gabuar,[45] ani se argumentet e tyre duket sikur provojnë të kundërtën. Këtë mund ta vërej lexuesi fare lehtë: mendimi i mospajtuesve është plotësisht joprofesional dhe i bazuar në argumente ekstra juridike dhe ekstra kushtetuese. Brenga e tyre kryesore, faktor ky subjektiv, të cilin ata megjithatë e kthejnë në argument, ka të bëjë me pasojat e vendimit të Gjykatës. Kjo sepse ata besojnë se, **inter alia**, vendimi i shumicës "[...] imponon shpërbërjen e Kuvendit dhe zgjedhjet e reja të përgjithshme". Kjo do të thotë se dy gjyqtarët mospajtues kanë qenë të bindur se verdikti i Gjykatës që deklaronte se Kuvendi ka shkelur Kushtetutën më 22 shkurt 2011 me rastin e zgjedhjes së **Behxhet Pacollit** për President të Republikës, ka qenë i barasvlefshëm me dështimin e Kuvendit për zgjedhë një president, pas raundit të tretë të votimit, ashtu që, për pasojë dhe në mënyrë automatike, vendi do duhej të ketë hyrë në zgjedhje të përgjithshme pas 45 ditësh.[46] Ky është një gabim themelor dhe mungesë e të kuptuarit të rolit dhe pozitës së Gjykatës Kushtetuese si interpretues përfundimtar i Kushtetutës.

Vendimi i shumicës nuk ka thënë, dhe nuk ka mund të thotë, se Kuvendi ka dështuar të zgjedhë Presidentin e Republikës. Ajo çfarë ka thënë Gjykata është se Kuvendi i Kosovës zgjodhi Presidentin e ri më

---

42 Cf. Paragrafët 57-61 të Aktgjykimit në rastin **KO 29/11.**

43 Ky lloj argumenti ekziston, siç e kemi sqaruar në kapitullin paraprak, atëherë kur struktura e argumenteve kushtetuese ka më shumë argumente paralele, përkatësisht kur përdoret një strukturë argumentuese kumulative ashtu që secili argument ka fuqi autonome dhe çon në të njëjtin përfundim. Thënë me fjalë të tjera, struktura argumentuese kumulative nënkupton se tërësia e argumenteve shpie në përfundim të njëjtë, në mënyrë të njëjtë siç shpijnë secili prej argumenteve të përdoruara (të cilat kanë fuqi autonome pavarësisht nga fuqia e argumenteve tjera).

44 European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Albania. Draft Opinion on the Powers of the President to Set Dates of Elections in a Parliamentary System*, paragrafët 41 & 42.

45 *Rasti Nr. KO 29/11. Sabri Hamiti dhe Deputetët e tjerë të Kuvendit të Kosovës. Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 04-V-04 Përkitazi me Zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, të 22 shkurt 2011*. **Mendimi Mospajtues i gjyqtarëve Robert Carolan dhe Almiro Rodrigues, datë 30 mars 2011**.

46 Neni 82 [Shpërndarja e Kuvendit] i Kushtetutës: "[...] 1. Kuvendi shpërndahet në këto raste: (1) nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e caktimit të mandatarit nga Presidenti i Republikës së Kosovës, nuk mund të formohet Qeveria; (2) nëse për shpërndarjen e Kuvendit votojnë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve, shpërndarja bëhet me dekret të Presidentit të Republikës së Kosovës; (3) nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e fillimit të procedurës së zgjedhjes, nuk zgjedhet Presidenti i Republikës së Kosovës. 2. Kuvendi mund të shpërndahet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pas votimit të suksesshëm të mosbesimit të Qeverisë".

22 shkurt 2011 në mënyrë jo kushtetuese, gjë që do të thotë se për ato tridhjetë e tetë apo më shumë ditë, Kosova ka pasur një President veprimet e të cilit ishin jo të vlefshme: asnjë vakum institucional nuk ka ekzistuar, siç mendojnë mospajtuesit, mes 22 shkurtit - 30 marsit 2011 (e fundit është data kur Gjykata nxori vendimin e vet). Kjo më tej nënkupton se Kryetari i Kuvendit u bë ushtrues detyre i kreut të shtetit që nga momenti kur Gjykata nxori vendimin e saj më 30 mars 2011, gjë që do të thotë se situata ishte e njëjtë me atë të krijuar me dorëheqjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, **Fatmir Sejdiu**. Në kuptim më konkret kushtetues kjo do të thotë se vendimi i shumicës nuk ka pasur asnjë efekt retroaktiv (**ex tunc**), por vetëm deklarativ të gjendjes ekzistuese që ka filluar të prodhoj efekte për të ardhmen (**ex nunc**).

Kjo pikëpamje e shumicës duket të ketë qenë e vështirë për t'u kuptuar jo vetëm nga gjyqtarët mospajtues por edhe nga qeveria e Kosovës, nga vetë **Behxhet Pacolli** dhe nga Kuvendi. Kjo vërtetohet më faktin se pas verdiktit në fjalë, të gjithë ata kërkuan sqarime shtesë të vendimit të sipërpërmendur të Gjykatës, duke çuar në një prononcim të dytë nga Gjykata, përmes një forme vendimmarrje të cilësuar si **Sqarimi të Aktgjykimit**. Gjykata nxori këtë vendim sqarues më 1 prill 2011, duke adresuar shqetësimet dhe paqartësitë e shprehura nga qeveria, nga vetë ish-presidenti **Behxhet Pacolli** dhe kryetari i Kuvendit, **Jakup Krasniqi.** Sqarimi shkoi përgjatë gjithë vijave siç u tha më lartë dhe mbylli përgjithmonë tregimin e dy presidentëve duke hapur rrugën për zgjedhjen e presidentit të ri të Kosovës, zonjës **Atifete Jahjaga**: udhëheqësit e Aleancës Kosova e Re (**AKR**), të Lidhjes Demokratike të Kosovës (**LDK**) dhe të Partisë Demokratike të Kosovës (**PDK**), Behxhet Pacolli, Isa Mustafa dhe Hashim Thaçi, nënshkruan një marrëveshje më datën 6 prill 2011. Sipas kësaj Marrëveshjeje, **Atifete Jahjaga** u nominua si kandidate për president të Republikës së Kosovës dhe palët përkatëse ofruan mbështetjen e tyre të plotë për kandidaturën e saj.

16.3. Rasti Jahjaga

Pozita e saj, megjithatë, u kontestua përsëri në **Gjykatën Kushtetuese**, por tani mbi një bazë tjetër - mbi bazën e kontrollit preventiv të kushtetutshmërisë së disa amendamenteve të propozuara kushtetuese. Në marrëveshjen si më sipër, u pat stipuluar që udhëheqësit pajtohen që menjëherë ta formohet një **Komision për Reformën e Zgjedhjeve Presidenciale** (**Komisioni**), që do t'i hartojë amendamentet kushtetuese dhe legjislacionin e ndërlidhur, të nevojshëm për të siguruar që **Presidenti i Kosovës** në të ardhmen të zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga populli, si dhe që zgjedhjet e drejtpërdrejta presidenciale në Kosovë të mbahen jo më vonë se gjashtë muaj nga dita kur këto amendamentime kushtetuese (së bashku me legjislacionin shtesë) hyjnë në fuqi.[47] Nga redaktimi i këtyre dispozitave të kësaj marrëveshjeje, bëhet e qartë se fjala ka qenë për përpjekje politike për të rrënuar një organ kushtetues përmes një pakti politik. Esenca e paktit qëndronte në teknikën juridike të amendamentimit kushtetues dhe që parashikonte, përmes amendamenteve kushtetuese që ndryshonin mënyrën e zgjedhjes së Presidentit të Kosovës, përfundimin e parakohshëm të mandatit të fituar në mënyrë kushtetuese të ish-presidentes **Atifete Jahjaga**. Kjo është kështu sepse, bazuar në këtë marrëveshje, ajo, si gruaja e parë president i Kosovës, mori pozitën dhe betimin e saj kushtetues. Ai betim nuk u bazua në marrëveshje politike të liderëve politik që u pajtuan që ajo të jetë president i Kosovës, por në Kushtetutë dhe atë për respektim të rendit kushtetues e ligjor në Kosovë.[48] Të shohim më nga afër si u zhvillua situata që në diskursin akademik ndërkombëtar njihet si **rasti i tentimit për shkarkim me amendamente kushtetuese të shefit të shtetit në Kosovë**.[49]

Më 15 prill 2011, shefat e grupeve parlamentare në Kuvendin e Kosovës dorëzuan një propozim në Kuvend për formimin e dy komisioneve: një komision për amendamentimin e Kushtetutës dhe një komision për amendamentimin e ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë. Ky propozim ishte në vijim të vënies në jetë të marrëveshjes së sipërcekur politike të udhëheqësve kryesor politik të Kosovës. Më

[47] Paragrafët 19-21 të Aktgjykimit në rastet **KO 29/12** & **KO 48/12**.

[48] Paragrafët 26-27 të Aktgjykimit në rastet **KO 29/12 & KO 48/12**.

[49] Enver Hasani, "Constitutional Protection of the Head of State: The Case of Kosovo". Në *Vienna Journal on International Constitutional Law – ICL Journal,* Volume 7, No. 2 (February 2013) fq. 128-149.

22 prill 2011, Kuvendi me 76 vota për, 4 abstenime dhe 6 vota kundër, e miratoi Vendimin Nr. 04-V-12, për formimin e **Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.** Më 20 mars 2012, kryesuesi i Komisionit ia dorëzoi Kuvendit amendamentimet e propozuara të Kushtetutës, të shoqëruar me listën e nënshkrimeve të 31 deputeteve te Kuvendit. Më 23 mars 2012, Kryetari i Kuvendit ia dërgoi amendamentimet e propozuara kryetarit të **Gjykatës Kushtetuese**, duke kërkuar që Gjykata të vlerësojë nëse amendamentet e propozuara pakësojnë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.[50]

Amendamenti 10 i propozuar quhej "Shpallja Zgjedhjeve të para Presidenciale" dhe propozonte që të futej një nen i ri kushtetues që do të normonte zgjedhjet e para presidenciale, por vetëm pasi të ndryshonte mënyra e zgjedhjes së Presidentit të Republikës nga zgjedhjet indirekte në zgjedhje të drejtpërdrejta nga populli. Amendamenti thoshte për sa vijon:

"[…] Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj Kushtetute:

(1) Zgjedhjet për Presidentin e Republikës se Kosovës, në përputhje me nenin 86 te Kushtetutës, mbahen brenda 6 (gjashtë) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të amendamenteve Kushtetuese dhe ligjeve relevante.

(2) Mandati i Presidentit të Republikës së Kosovës, i zgjedhur nga Kuvendi, sipas dispozitave te mëhershme të Kushtetutës, vazhdon derisa Presidenti i ri të zgjidhet dhe të beje betimin.

(3) Presidentet që kanë shërbyer para hyrjes në fuqi të këtyre amendamenteve, kanë të drejtë të zgjidhen dhe rizgjidhen edhe një herë si President i Republikës së Kosovës."

Një amendament si ky, sipas vlerësimit të Gjykatës, paraqiste disa probleme meqë, në rend të parë, ia shkurtonte mandatin presidentes së kohës **Atifete Jahjaga**, e cila kishte dhënë betimin dhe marrë detyrën në mënyrë krejtësisht kushtetuese. Në verdiktin e saj, Gjykata u kujdes që ta bënte të qartë se mënyra e drejtpërdrejtë e zgjedhjes së Presidentit të Kosovës nuk përbënte asnjë problem kushtetues në vetvete.[51] Përkundrazi, një mënyrë e tillë e zgjedhjes së shefit të shtetit paraqiste një pasurim të të drejtave demokratike të qytetarëve kosovarë. Esenca e problemit kushtetues në këtë rast qëndronte diku tjetër, në gjykimin nëse mënyra e përfundimit të mandatit të shefit aktual të shtetit të Kosovës përbënte cenim të lirive dhe të drejtave nga kapitulli II i Kushtetutës, germën dhe frymën e saj ashtu siç është interpretuar nga Gjykata Kushtetuese. Për të përcaktuar këtë, Gjykata përdori argumente të theksuara **këmbët e karriges**, duke u mbështetur në metodën krahasuese, ashtu që secili argument i dhënë në paragrafët 247-271 të aktgjykimit për këtë rast, në mënyrë autonome shpie në përfundimin e njëjtë, përkatësisht se përfundimi i parakohshëm i mandatit të Presidentit të Republikës përmes amendamentit kushtetues përbën shkelje të Kushtetutës. Ajo shkelje e Kushtetutës konsiston në pakësimin e lirive dhe të drejtave nga Kapitulli II i Kushtetutës.

Në këtë konstatim Gjykata ka arritur pas një argumentimi të gjatë në paragrafët e sipërcekur. Në fillim, ajo ka konstatuar se më datën 7 prill 2012, znj. **Atifete Jahjaga** ishte zgjedhur presidente e Republikës së Kosovës dhe kishte dhënë betimin po atë ditë, ashtu siç përcaktohet me Kushtetutë. Me këtë ka pasuar fillimi i ushtrimeve të detyrave të saj kushtetuese, si përfaqësuese legjitime e Kosovës brenda dhe jashtë dhe si garantuese e funksionimit demokratik të institucioneve të Kosovës, në pajtim me nenin 83 [Statusi i Presidentit] të Kushtetutës. Kjo rrethanë, sipas Gjykatës, nënkuptonte që çdo shkurtim i mandatit të saj privon qytetarin e Kosovës nga pasja e një përfaqësuesi legjitim dhe e një garantuesi të funksionimit demokratik të institucioneve kushtetuese, për kohën sa zgjatë mandati kushtetues i Presidentit prej pesë (5) vjetësh. Këto dy cilësi si më sipër të shefit të shtetit, së bashku me kohën prej pesë (5) vjetësh sa zgjat mandati, përbëjnë thelbin e mandatit kushtetues, jo vetëm kompetencat nga neni 84 [Kompetencat e Presidentit] të Kushtetutës. Ky mandat është politik dhe nënkupton që ekziston një e drejtë pasive për t'u zgjedhur që u takon të gjithëve, përfshirë ish-Presidenten **Atifete Jahjaga**. Këto konstatime të Gjykatës

[50] Paragrafët 30-32 të Aktgjykimit në rastet **KO 29/12 & 48/12.**

[51] Paragrafët 251-257 të Aktgjykimit në rastet **KO 29/12 & 48/12.**

u nxorën duke iu referuar zgjidhjeve juridike kushtetuese krahasuese në planin ndërkombëtar.[52] Gjykata tutje tregoi se presidentes A. Jahjaga i mohohej edhe e drejta për mjete efektive juridike: një shkurtim i tillë i mandatit përmes amendamentit kushtetues domosdo që privon atë nga ushtrimi i mjeteve efektive juridike, një e drejtë kjo kushtetuese e secilit qytetar, përfshirë Presidentin e Republikës. Për këto dhe disa arsye të tjera, siç janë cenimi i të drejtave të tjera që lidhen me sigurinë juridike dhe me pronën, në fund Gjykata shpalli jo kushtetues këtë amendament, së bashku me shtatë (7) amendament e tjera të propozuara.[53]

Gjykata, e thënë me fjalë të tjera, gjeti se është jo kushtetues çdo veprim, përmes amendamentit ose në ndonjë mënyrë tjetër, që synon në ndërprerjen e parakohshme të mandateve ekzistuese kushtetuese, duke përfshirë mandatin e ish-Presidentes **Atifete Jahjaga**. Përfundimi i mandatit kushtetues mund dhe duhet të ndodhë vetëm nëpërmjet mënyrave të paracaktuara kushtetuese. Ky qëllim i politikës kosovare për të përdorur **Gjykatën Kushtetuese** me qëllim të konstitucionalizmit të qëllimeve të politikës ditore të mishëruara në marrëveshjen e datës 6 prill 2012 të udhëheqësve të Kosovës u mposht dhe u sigurua vazhdimi i mandatit të Presidentit të Republikës, znj. **Atifete Jahjaga**. Ky vendim përbën një triumf të konstitucionalizmit kundrejt rrymave politike që u përpoqën të shkarkojnë një organ kyç kushtetues, kreun e shtetit, përmes përdorimit të një teknike juridike për ndryshim kushtetues, përkatësisht përmes përdorimit të amendamentimit kushtetues.

16.4. Rasti AKP

Rasti i njohur si **AKP** ka të bëjë me kontrollin kushtetues të Vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës ("Dhoma e Posaçme" apo vetëm "Dhoma"), ASC -09-089, të 4 shkurtit 2010.[54] Parashtruesi, **AKP**, pretendonte se, në veçanti, vendimi i lartpërmendur i **Dhomës së Posaçme**, që ishte objekt i vlerësimit të kushtetutshmërisë në Gjykatë, kishte shkelur dispozitat si vijon të Kushtetutës:

- nenin 3.2 [Barazia para Ligjit];
- nenin 31 (2 & 3) [E Drejta për Gjykim të Drejtë e të Paanshëm];
- nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave];
- nenin 102 (1 & 4) [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor];
- nenin 112.2 [Parimet e Përgjithshme];
- nenin 116.3 [Efekti Juridik i Vendimeve];
- nenin 143 [Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës]; dhe
- nenin 145.2 [Vazhdimësia e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe Legjislacionit të Aplikueshëm] të Kushtetutës

Në fund, parashtruesi pretendonte se bëhej fjalë edhe për shkeljen e nenit 13 [E Drejta për Mjete Efektive] të **Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut** (KEDNJ).

Përmbajtja e vendimit të **Dhomës së Posaçme**, i cili ishte objekt i kontrollit kushtetues, ngërthente në vete dy qëndrime jo kushtetuese, të cilat çuan në anulimin e tij dhe në urdhrin e Gjykatës Kushtetuese drejtuar autorit të vendimit për rivënien e kushtetutshmërisë me rastin e rivendosjes së çështjes.

Situata faktike, ndërkaq, ka pasur të bëj me kërkesën e **AKP** për të përfaqësuar interesat e punëtoreve në çështjet e privatizimit pranë **Dhomës së Posaçme** (e cila gjykonte, atëherë dhe sot, çështjet që kanë të bëjnë me privatizimin. **AKP**, sipas ligjit kosovar, konsiderohet si trashëgimtare e të ish-**Agresionit Kosovar të Mirëbesimit** (**AKM**), e themeluar pas vitit qershorit të vitit 1999 nga autoritetet e **UNMIK**-ut (administrata Kombeve të Bashkuara në Kosovë).

Esenca e problemit kushtetues të lindur rreth nxjerrjes së vendimit si më sipër të **Dhomës së Posaçme** të **GJSK** përmblidhet në të dy qëndrimet e saj, të cilat mbështeteshin në **fiksione juridike** të paqëndrueshme dhe irracionale në kuptimin juridik-kushtetues. Këto qëndrime kishin të bënin me rolin dhe pozitën e **AKP**-

52 Paragrafët 259-260 të Aktgjykimit në rastet **KO 29/12 & 48/12.**

53 Paragrafi II i pjesës operative të Aktgjykimit në rastet **KO 29/12 & 48/12**.

54 Cf. fusnota nr. 7, **supra**, dhe teksti që e shoqëron.

së, si një rival i **AKM**-së. I pari qëndrim i Dhomës thoshte se **AKP** ishte një agjenci pa status të personit juridik ashtu që çdo aktivitet i saj duhej të konsiderohej si një aktivitet faktik i kryer jashtë autorizimeve të **AKM**, si përfaqësuese e vetme e autorizuar e autoriteteve të **UNMIK**-ut në çështjet e privatizimit.[55] Qëndrimi i dytë insistonte se ligji që themelonte **AKP**-në nuk ishte veçse një rregullore e brendshme, jo si një ligj i vërtetë i nxjerrë nga **Kuvendi i Kosovës.**[56]

Këto qëndrime të **Dhomës së Posaçme** preknin esencën e dy pushteteve kushtetutëbërëse: në rend të parë, ato preknin **pouvoir constitutant originaire** të **Kosovës**, ashtu siç u deklarua ai vullnet më 17 shkurt 2008 përmes **Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës**, autorë të së cilës ishin përfaqësuesit e zgjedhur të popullit të Kosovës; dhe, në rend të dytë, ato preknin edhe vetë esencën e mënyrës së ushtrimit të autoritetit shtetëror nga ana autoriteteve të reja kosovare të themeluara në mënyrë të rregullt pas shpalljes së pavarësisë (pengimi i ushtrimit të **pouvoir** *constitué* **originaire** nga ana e organeve të zgjedhura sipas Kushtetutës së vitit 2008). E thënë me fjalë të tjera, ky qëndrim i Dhomës prekte si pushtetin origjinal konstituiv (**pouvoir costitutant originaire**) ashtu edhe të drejtën për ushtrimin e pushtetit të konstituar të Kosovës pas shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt 2008 nga ana e organeve kushtetuese (**pouvoir** *constitué*). Kjo situatë e krijuar kësisoj ka nevojë për një qartësim të mëtejmë për lexuesit lidhur me çështjet si në vijim: çka është **Dhoma e Posaçme**? Cili është autoriteti i saj? Çka është **AKP** dhe ligji sipas të cilit vepron brenda rregullit kushtetues të Kosovës?

Procesi i privatizimit në **Kosovë** që filloi menjëherë pas instalimit të administratës ndërkombëtare të **UNMIK**-ut më 10 qershor 1999, nën mbikëqyrjen e Kombeve të Bashkuara, ka pasur specifikat e veta. Në fakt, çdo proces i privatizimit pas kolapsit të komunizmit më 1989 ka qenë specifik në varësi të karakteristikave të secilit shtet.[57] Në këtë drejtim, **Kosova** nuk bën përjashtim. Specifikat më e madhe e Kosovës, ndër të tjera, konsiston në atë se i tërë procesi i privatizimit ka qenë i udhëhequr nga **UNMIK**-u, në ndërkohë që organet dhe autoritetet vendore nuk kanë shërbyer si vendimmarrës. Në thelb, prezenca e vendorëve aty ka qenë vetëm sa për sy e faqe.[58]

Baza juridike për këtë lloj privatizimi ka qenë **Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12 për Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit** e datës 13 qershor 2002. Sipas kësaj Rregulloreje, **AKM** ka shërbyer si institucion përgjegjës për të udhëhequr tërë procesin e privatizimit në Kosovë pas 10 qershorit 1999, përderisa **Dhoma e Posaçme** ishte organi për të gjykuar dhe vendosur për çështjet në lidhje me privatizimin.[59] Pas Deklaratës së Pavarësisë, ndërkaq, Kuvendi i Kosovës nxori një ligj që normonte materien e njëjtë, Ligji

---

55 **Rasti KI 25/10:** "[…] 46. Gjykata vëren se, sipas sqarimit qe e paraqiti PSSP-ja më 12 nëntor 2009 tek Presidenti i Kolegjit të Ankesave te Dhomës se Posaçme, "qëndrimi i përgjithshëm i UNMIK-ut karshi AKP-së është i njohur dhe është sjellë në vëmendje të Dhomës së Posaçme në raste të ndryshme të shqyrtuar nga kjo Dhomë... Edhe nëse merret parasysh kuptimi ligjor sipas vetë AKP-së, njohja e legjislacionit të Kuvendit të Kosovës si bazë ligjore, që nënkupton themelimin e AKP-së, tregohet i pasuksesshëm. Legjislacioni i AKP-së shkel të drejtat themelore nga të cilat synon të pranojë legjitimitet: Aneksi VII, neni 2.1 i propozimit të Ahtisarit". Sqarimi, për më tepër, përmend se "AKP nuk është themeluar në bazë të ligjit në fuqi në Kosovë" dhe në pajtim me rezolutën 1244 (1999) të KSKB-së dhe nuk mund të trajtohet në mënyrë ligjore si pasardhës i ligjshëm i AKM-së... ", dhe se "AKP-së nuk mund t'i akordohet statusi i personit juridik" si dhe "... diskrecioni i Dhomës së Posaçme për ta quajtur AKP-në me zotësinë e saj si person jo-juridik...".

56 **Rasti KI 25/10:** "[…] 47. Sa i përket pyetjes nëse Kolegji i Ankesave ka marrë parasysh sqarimin e UNMIK-ut në Vendimin e vet ASC-09-089, siç pretendohet nga parashtruesi, Gjykata vëren se interpretimi i ofruar nga sqarimi i UNMIK-ut qartazi reflektohet në vendimin e Kolegjit, p.sh. kur thekson se "pranon aktivitetet e AKP-së si çështje fakti të qarta" dhe "... Ligji mbi AKP-në..., sipas të cilit AKP-ja është themeluar si institut faktik...". Kolegji i Ankesave, për me tepër, pohon se "kjo nuk do të thotë se, Dhoma e Posaçme pranon Ligjin e AKP-së si ligj të aplikueshëm në Kosovë, por, per të siguruar një proces të sigurt dhe të drejtë të privatizimit, ky ligj i AKP-së duhet të trajtohet si rregulla te vlefshme dhe detyruese brenda organizatës, në kuadër të procesit të privatizimit".

57 Cf. më shumë në lidhje me këtë në një studim elokuent nga Csongor Kuti, Post-Communist Restitution and the Rule of Law (Central European University Press: Budapest/New York: 2009)

58 Cf. më shumë në lidhje me këtë në një artikull në shqip, me një rezime në anglisht, të shkruar nga Haxhi Gashi, "Konflikti Lidhur me Privatizimin e Ndërmarrjeve Shoqërore: Ndryshimi i Ligjit per Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme, i Ligjit për AKP-në dhe Ligjet Relevante ("The Conflict of Laws Concerning the Socially Owned Enterprises"). *E drejta /Law* (Fakulteti Juridik, Prishtinë) Nr. 2/2011, fq. 47-63.

59 **Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/13 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Ndërlidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit**, me ndryshime. Datë: 13 qershor 2002.

për Themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, **Ligji nr. 03/L-067**, datë 21 majit 2008. Kjo përfaqësonte ushtrimin e pushtetit konstituiv (**pouvoir** *constitué*) nga ana e organeve të reja të **Kosovës** si një shtet sovran dhe i pavarur.

Ligji nr. 03/L-067 parashikonte që **Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12** do të pushojë së prodhuari efekt juridik në datën e hyrjes së tij në fuqi. Çështja e kolizionit në mes të objektit të rregullimit të këtyre dy akteve juridike duhet parë në dritën e një ligjit tjetër të nxjerrë nga Kuvendi i Kosovës pas shpallës së pavarësisë së vendit: më parë, Kosova si shet sovran dhe i pavarur kishte nxjerrë **Ligjin nr. 03/L-053 për Juridiksionin, Përzgjedhjen e rastit dhe Caktimin e rastit, të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Misionit EULEX në Kosovë**, datë 13 mars 2008. Ky ligj ishte dizajnuar ashtu që të rregullonte aspektet juridike të integrimit dhe juridiksionin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të **EULEX**-it, ku hynin edhe gjyqtarët që punonin në **Dhomën e Posaçme të GSK**. Burim i keqkuptimeve që kanë çuar në krijimin e këtij rasti kanë qenë interpretimet e dhëna për **Ligjin nr. 03/L-053** nga Dhoma e Posaçme, e cila, në vend se të shfrytëzonte **Ligjin nr. 03/L-053** si bazë për të urëzuar dallimet në mes të gjyqtarëve kosovarë dhe kolegëve të tyre të EULEX-it, që punonin së bashku në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, i mohoi statusin juridik **AKP**-së për çështjet e privatizimit duke e konsideruar **AKM**-në si të vetmin përfaqësues të Dhomës së Posaçme kurse **Ligjin nr. 03/L-067** si një rregullore të brendshme që duhej të respektohej dhe zbatohej nga një agjenci **de facto** që njihet me emrin **AKP**.

Ky qëndrim i Dhomës është shprehur në vendimin **ASC-09-089** të 4 shkurtit 2010, që ishte objekt kontrolli kushtetues në Gjykatën Kushtetuese. Në aktgjykimin për këtë rast, Gjykata konstatoi se **Vendimi ASC-09-089** ishte në kundërshtim me shumë norma dhe vlera të Kushtetutës së vitit 2008. Rëndësia e këtij rasti në diskutimin tonë, megjithatë, nuk fokusohet tek pjesa kryesore e aktgjykimit që ka të bëj me analizën e Gjykatës për shkeljen e dispozitave të veçanta kushtetuese dhe vlerave thelbësore që mishërohen në to,[60] por në analizën që Gjykata ka bërë në lidhje me **pouvoir constituant originaire**, ashtu siç është shprehur ai me rastin e shpalljes së Kosovës shtet sovran dhe i pavarur. Kjo analizë është e përfshirë në paragrafin 54 të aktgjykimit në fjalë, ku Gjykata ia bën të qartë Dhomës, në një mënyrë shumë profesionale, se akti i shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 nuk bazohet në normat e një rendi të mëparshëm juridik, siç do ta formulonte Karl Shmit (**Carl Schmitt: 1888-1985)**,[61] përkatësisht ne normat e prodhuara nga **UNMIK** në bazë të Rezolutës 1244 të KS të OKB-së. Ky akt, që njëkohësisht shënon ushtrimin e pushtetit origjiner konstituiv (**pouvoir constituant originaire**) të popullit të Kosovës, u ka dhënë fund kompetencave dhe normave të të gjitha autoriteteve tjera. Mbi bazën e aktit të shpallës së pavarësisë si një **grundnorm** e re e Kosovës janë nxjerrë dhe prodhuar aktet relevante juridiko-kushtetuese, të cilat, si të tilla, nuk vijnë nga një rend i mëparshëm juridik i krijuar nga **UNMIK**-u (i bazuar në Këshillin e Sigurimit të **OKB**-së nr. 1244 të 10 qershorit 1999). Shih për këtë, akti i datës 17 shkurt 2008 nuk ka shkelur ndonjë normë të veçantë apo të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare sepse ka ndodhur jashtë rendit juridik të **UNMIK**-ut dhe nuk ka pasur për qëllim që të prodhoj efekte juridike brenda atij rendi por jashtë tij.

Këto shtjellime të **Gjykatës Kushtetuese**, në thelb, bazoheshin në verdiktin e **Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë** (GJND), të dhënë më datën 22 korrik 2010 lidhur me ligjshmërinë e aktit të shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës.[62] Me këtë shtjellim në këtë pjesë që lidhet me verdiktin e **GJND**-së, **Gjykata Kushtetuese** në mënyrë të qartë i ka treguar **Dhomës së Posaçme** se ajo është pjesë e pandashme e rendit juridik-kushtetues të shtetit të Kosovës, me një status të veçantë. Kjo nënkuptonte se Dhoma nuk kishte asnjë të drejtë të marrë e të zgjedhë sipas dëshirës saj se cilat ligje duheshin zbatuar

---

60 Cf. Paragrafët 45-53 dhe 55-62 të Aktgjykimit në rastin **KI 25/10.**

61 Cf. më shumë në lidhje me këtë në Carl Schmitt, *Political Theology; Four Chapters on the Concept of Sovereignty* (The University of Chicago Press: Chicago, 2005) fq. 16-35; Slobodan Samardzic (ed), *Norma i Olduka: Karl Smit i Njegovi Kriticari* ("Filip Visnjic": Beograd, 2001) fq. 85-124.

62 *Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in Respect of Kosovo. Advisory Opinion of 22 July 2010.* Paragrafët e **Mendimit Këshillëdhënës**: 52-56; 74-84; 96-109; 114-121. Në internet: https://www.icj-cij.org/files/case-related/141/141-20100722-ADV-01-00-EN.pdf (shikuar në shkurt 2020).

dhe as për të kualifikuar ligjet dhe aktet juridike të Kuvendit të Kosovës si entitete dhe norma **de facto** të nxjerra nga autoritetet kosovare brenda juridiksionit të **UNMIK**-ut dhe rendit të tij juridik. Shikuar nga ky prizëm, **Gjykata Kushtetuese** vëri në dukje se **Dhoma e Posaçme** ishte pjesë integrale e **GJSK**, funksioni kryesor i së cilës është që të sigurojë zbatim të njëtrajtshëm të ligjit në tërë territorin e Kosovës. Ky funksion, funksioni **nomofilaktik**, ushtrohet, në thelb, nga çdo gjykatë supreme apo gjykatë tjetër që ka gradën më të lartë në hierarkinë gjyqësore nacionale. E thënë me fjalë të tjera, qasja e Dhomës sipas së cilës ligjet e Kosovës që normonin materien e privatizimit ishin norma të brendshme që normonin organizimin dhe funksionimin e brendshëm të një organizmi faktik, i njohur si **AKP**, pra si diçka që nuk ka status juridik të pavarur për të qenë palë në procedurë, përbënte një shkelje kushtetuese që nuk mund të tolerohej. Një praktikë e tillë jo kushtetuese duhej ndërprerë menjëherë, konstatoi **Gjykata Kushtetuese**, sepse ishte në kundërshtim më rolin dhe pozitën kushtetuese të **GSK**, pjesë përbërëse e së cilës ishte **Dhoma e Posaçme**. Ky rol dhe kjo pozitë e saj kishte një komponentë të rëndësishme, komponenta e kujdesit për zbatimin uniform të ligjeve në tërë territorin e Kosovës. Një gjë e tillë, për pasojë, nënkuptonte që në territorin e Kosovës nuk mund të ekzistonin entitetet që trajtojnë ligjet e **Kuvendit të Kosovës** si rregulla të brendshme pa vlerë ligjore, kurse organizmat e krijuar në bazë të tyre, si entitete faktike që nuk kanë status juridik për të qenë bartës të pavarur të të drejtave dhe detyrimeve.

16.5. Rasti VLAN

Dy nga aktgjykimet e **Gjykatës Kushtetuese**, të nxjerra në kontekst të zgjedhjeve të përgjithshme të qershorit 2014, përbëjnë të a.q. **rasti i ngërçit**. Zgjedhjet në fjalë nga vëzhguesit e huaj qenë vlerësuar me notë të mirë, përkatësisht si zgjedhjet më të mira që nga pas lufta. Një cilësi e re e tyre ka qenë pjesëmarrja e serbëve lokal në veri të vendit, për herë të parë që nga mbarimi i luftës në qershor të vitit 1999.[63]

Sipas Kushtetutës, Kosova ka një sistem zgjedhor proporcional me lista të hapura.[64] Kuptimi i fjalës "shumicë" për qëllimet e formimit të organeve qendrore shtetërore pas zgjedhjeve nacionale definohet në mënyrë shumë të qartë në Kushtetutë: "shumicë" konsiderohet ajo parti ose ai koalicion që ka marrë pjesë në zgjedhjet e përgjithshme dhe fiton më së shumti ulëse në Kuvend të Kosovës.[65] Në të njëjtën kohë, një gjë e tillë nënkupton tri gjëra, të cilat janë si vijon:

- e para, shumicat në kuptimin e mësipërm nuk mund të formohen në ndërkohën e certifikimit të zgjedhjeve e deri të inaugurimi (formimi) i organeve të reja shtetërore, bazuar në rezultatin zgjedhor;
- e dyta, asnjë aleancë apo koalicion i i ri jashtë atij të formuar si ofertë për zgjedhësin, mbi bazën e të cilit është hedhur vota ne zgjedhje, nuk mund të përmbysë rezultatin që ka dalë nga zgjedhjet ashtu që edhe trupat e ri shtetëror formohen duke u bazuar në këtë rezultat; dhe
- e treta, që mandati për të formuar qeverinë dhe për të pasur kryetarin e Kuvendit të Kosovës duhet dhënë partisë apo koalicionit që ka fituar në kuptimin si më sipër, përkatësisht që ka fituar shumicën e ulëseve në Kuvendin e Kosovës në krahasim me partitë apo koalicionet tjera që kanë marrë pjesë në zgjedhjet nacionale.

Këto tri postulate të Kushtetutës, për aq sa ato kanë të bëjnë me formimin e trupave qendror të pushtetit (Kuvendit dhe Qeverisë) u sfiduan nga opozita, e përbërë nga partitë: **LVV** (Lëvizja Vetëvendosje), **LDK**

---

63 Për një analizë të thukët të të gjitha zgjedhjeve dhe monitorimin e tyre, shih Adem Beha and Bekim Baliqi, *2014 Elections in Kosovo: A Retrospective* (Department of Political Science of the University of Prishtina "Hasan Prishtina", Pristina, 2014). Në internet: http://www.academia.edu/8335856/2014.Elections_in_Kosovo_A_Retrospective> (shikuar në shkurt 2020).

64 Neni 64.1 [Struktura e Kuvendit] i Kushtetutës: "Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin".

65 Neni 95.1 [Zgjedhja e Qeverisë] i Kushtetutës: "Pas zgjedhjeve, Presidenti i Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë."

(Lidhja Demokratike e Kosovës), **AAK** (Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës) dhe **NISMA** (Nisma për Kosovën). Për këtë arsye edhe akronimi **VLAN**. Kjo opozitë pohonte se kuptimi i fjalës "shumicë" nënkupton çdo "shumicë" që formohet kurdo (para dhe pas certifikimit të rezultateve) dhe kudo (në Kuvend të Kosovës apo nëpër kafenetë e dhe kuluaret e rrugëve të kryeqytetit).[66] Mbi bazën e këtij kuptimi të fjalës "shumicë", pas certifikimit të rezultateve zgjedhore të zgjedhjeve të 8 qershorit 2014, partitë politike që humbën zgjedhjet formuan një "shumicë" që synonte jo formimin e organeve të reja të pushtetit shtetëror por bllokimin e atyre që kishin dalë të parët në kuptimin e sipërm konform sistemit kushtetues zgjedhor proporcional.

Në fillim ky bllok i ri i "shumicës" humbëse bllokoi formimin e **Kuvendit të Kosovës** e më pas edhe të Qeverisë. Insistimi i tyre ishte që ata, si opozitë, ishin në komandë të "shumicës" parlamentare, ani se ende nuk ishte konstituar Kuvendi i Kosovës (sic!), në krahasim me fituesit e zgjedhjeve (një koalicion i partive që kishte dal fitues i zgjedhjeve, duke fituar më së shumti ulëse të certifikuara për Kuvendin e Kosovës).[67] Kjo situatë kishte të bënte, siç u tha, me formimin e Kuvendit të Kosovës dhe të Qeverisë pas zgjedhjeve të përgjithshme nacionale të atij viti.

Bllokada nga "shumica" e re e formuar nga humbësit e zgjedhjeve shkaktoi një bllokadë prej më shumë se pesë muajsh, kohë në të cilën Kosova ngeli pa kuvend dhe qeveri. Në këtë **interregnum**, Gjykata Kushtetuese nxori dy aktgjykime, të cilat në diskursin publik u njohën si aktgjykimet lidhur me rastin **VLAN I:** i pari ka të bëj me formimin e ekzekutivit kosovar,[68] kurse i dyti me organin kryesor përfaqësues të popullit të Kosovës.[69]

Filozofia praktike e opozitës u bë objekt i kërkesës së tyre pranë **Gjykatës Kushtetuese**, argument kryesor i së cilës ishte se ata ishin "shumicë" dhe, për pasojë, duhej të udhëhiqnin me caktimin e kryetarit të Kuvendit dhe formimin e Qeverisë së Kosovës. Sipas tyre, koalicioni pas-zgjedhor komandonte shumicën absolute (kategori që nuk njihet në sistemin proporcional zgjedhor në Kosovë dhe gjetiu), përkundër faktit që ata kishin marrë pjesë dhe kishin dal humbës në zgjedhjet nacionale. Gjykata rrëzoi kërkesën e tillë të opozitës dhe njohu të drejtën e koalicionit të partive që kishte dal fitues në zgjedhjet nacionale të drejtën e vetme për të udhëhequr formimin e organeve të reja qendrore të pushtetit.[70] Me këtë Gjykata dha përgjigje në një çështje kruciale kushtetuese, që ka të bëj me të drejtën e përparësisë për udhëheqjen me procesin e formimit të organeve qendrore të pushtetit shtetëror (Kuvendit dhe Qeverisë). Përgjigja në fjalë është e strukturuar përmes argumenteve kushtetuese të përdorura paralelisht, të cilat, megjithatë, individualisht nuk i provojnë në mënyrë përfundimtare faktet kushtetuese, përveç nëse merren në shqyrtim të gjitha së bashku.

Kjo strukturë argumentative, siç e kemi thënë në kapitullin paraprak, njihet ndryshe si "**argumenti me strukturë dialoguese"**: këtu parashtrohen dhe mbarështohen konsiderata të ndryshme, të cilat në vendim prezantohen si diçka që nuk janë as të domosdoshme dhe as të nevojshme për të nxjerrë një konkluzion përfundimtar, por vetëm si elemente treguese me rëndësi për zgjidhjen e rastit apo mosmarrëveshjes kushtetuese. Në rastin konkret, përgjigja konsistonte në interpretimin strikt të normave kushtetuese që normojnë themelimin e organeve qendrore pas zgjedhjeve nacionale ashtu që në të ardhmen mos të ketë asnjë paqartësi rreth tyre. Një qëndrim i tillë i Gjykatës bazohet në praktika dhe zgjidhje krahasuese, të cilat u mbarështuan një nga një në dy vendimet e sipërcekura, për t'i treguar kërkuesit

---

66 "Kushtetuesja përgjigjet këtë javë", **ZËRI** (21 qershor 2014), fq. 7; Presidentja mes "mes dy zjarresh", **ZËRI** (23 qershor 2014), fq. 1–2. (shikuar në shkurt 2020).

67 "Zyrtare: pdk – 37 deputetë, partia e parë në zgjedhjet e 8 qershorit", **TELEGRAFI** (26 qershor 2014). Në internet:https: telegrafi.com/zyrtare-pdk-37-deputete-partia-e-pare-ne -zgjedhjet-e-8-qershorit (shikuar në shkurt 2020).

68 Cf. fusnota nr. 8, **supra**, dhe komentet tona lidhur me të.

69 Cf. fusnota nr. 8, **supra**, dhe komentet tona lidhur me të.

70 Lidhur me formimin e qeverisë së **Kosovës** pas zgjedhjeve të qershorit 2014, cf. paragrafët 47-95 dhe pjesën operative të aktgjykimit në rastin **VLAN I;** Lidhur me formimin e Kuvendit të Kosovës pas zgjedhjeve të qershorit 2014, cf. paragrafët 116-119 dhe pjesën operative II nën "b" të Aktgjykimit në rastin **VLAN II.**

se zgjidhjet kushtetuese kosovare ishin të ndryshme nga vendet tjera dhe praktikat e tyre, në të cilat lejohet përmbysja e rezultateve zgjedhore përmes koalicioneve paszgjedhore. Në Kosovë ky nuk ishte rasti dhe kjo bazohej, sipas interpretimit të Gjykatës, jo vetëm në zgjidhjet e qarta kushtetuese të vitit 2008, por edhe në praktikën e formimit të organeve qendrore sipas Kornizës Kushtetuese të vitit 2001. Shih për këtë, pra për shkak të divergjencave në zgjidhjet dhe praktikat e jashtme kushtetuese, struktura argumentative e këtyre dy vendimeve është e njëjtë: dy vendimet kanë **strukturë dialoguese** ashtu që paragrafët e tyre nuk mund të japin përgjigje në kërkesat e parashtrua në mënyrë të ndarë. **Thënë me fjalë të tjera, pa u parë në tërësinë e tyre, rreshtat e vendimeve si më sipër nuk japin një përgjigje të qartë për lexuesin, i cili duhet secilin argument ta marrë si dialogues me kërkesën e parashtruar, pa dhënë përgjigje deri në fund të tekstit të secilit prej dy vendimeve në fjalë**. Kështu, ta zëmë, kur jepen argumentet që sqarojnë se në vendet fqinje me Kosovën ekzistojnë zgjidhjet kushtetuese që i japin shefit të shtetit të drejtën për caktuar mandatarin apo i japin deputetëve të drejtën për t'ia dhënë kryetarin e parlamentit secilës forcë politike që komandon më së shumti vota në parlament (jo në kutitë e votimit), kjo bëhet për t'i treguar palëve në procedurë dhe publikut se ato zgjidhje nuk thonë asgjë për situatën në Kosovë. Në rastin kosovar zgjidhjet kushtetuese dhe përvojat pas vitit 1999, si pasojë e natyrës së **demokracisë kushtetuese konsociacionale**, çojnë në një përfundim tjetër, për shkak se sistemi proporcional i zgjedhjeve ka për qëllim ruajtjen me çdo kusht të balancit politik të forcave që del nga zgjedhjet, jo që formohet më pastaj. Këtu bëhet fjalë gjithnjë për situatat që kanë të bëjnë me inaugurimin fillestar të punës së institucioneve qendrore. Kjo nuk është e tëra!

Duhet vënë në dukje se vota e lirë e qytetarit çon peshë edhe në formimin e më pastajmë të disa organeve të tjera kushtetuese që kanë të bëjnë me organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve të lira, siç është **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** (**KQZ**). Ky organ nuk mund të riformatizohet sipas ndryshimeve në spektrin politik në **Kuvendin e Kosovës**, ku një parti mund të bashkohet me tjetrën në Kuvend, apo disa kandidatë mund të kalojnë në një parti tjetër në Kuvend. Riformatizimi i këtij organi kushtetues çdoherë bëhet në bazë të rezultatit të fundit të dal nga zgjedhjet. Vetëm vota e lirë e fundit duhet të jetë pikë referimi për përbërjen e **KQZ**, jo fluktuimet ditore politike në Kuvend. Këtë frymë e ka ndjekur edhe Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj lidhur me përbërjen e **KQZ.** Këtë kërkesë e kishte paraqitur Presidenti i Republikës (**rasti KQZ**).[71]

Esenca e këtij rasti ka qenë kjo: pas zgjedhjeve të fundit nacionale, **LVV** ishte ndarë në dysh, ashtu që një pjesë e tyre, dymbëdhjetë deputetë, kishin formuar grup të ri parlamentar. Ai grup kërkonte më ngulm që të ketë anëtarin e vet në **KQZ**. Këtë kërkesë Presidenti e kishte miratuar heshtazi duke mos dekretuar anëtarin e ri, të ngelur vakant, në emër të **LVV.** Pas një viti ngecje dhe presionit të jashtëm, Presidenti u detyrua t'i drejtohej **Gjykatës Kushtetuese** për interpretim, ani se nuk kishte të drejtë meqë nuk kishte një akt juridik për t'u sfiduar nga ana e tij, në kuptim të nenit 113, pikat 2 & 3 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës. Gjykata refuzoi kërkesën si të papranueshme për mungesë të **legjitimitetit aktiv** të Presidentit të Republikës, me plot të drejtë.[72] Në pjesën e arsyetimit, Gjykata po ashtu u fut në analiza meritore të rastit, në veçanti duke theksuar se nuk ishte kompetencë kushtetuese e Presidentit të Republikës për të emëruar anëtarët e **KQZ.** Këtë konstatim Gjykata e bazoj, në mënyrë krejt të gabuar, në shtjellimin e dispozitave të nenit 84.9 [Kompetencat e Presidentit] në lidhje me nenin 113 pikat 2 & 3 të Kushtetutës. Kjo ndodhi si rrjedhojë e përpjekjeve të saj për të definuar konceptin çështje kushtetuese, me qëllim që, më pastaj, atë koncept ta futë nën dispozitat e nenit 113 pikat 2 & 3 të Kushtetutës.[73]

---

71 *Rasti KO 79/18. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Presidenti i Republikës së Kosovës. Kërkesë për interpretim të nenit 139 paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, 3 dhjetor 2018. Nr. ref.: RK 1294/ 18.

72 **Rasti KO 79/18:** "[…] 68. Në lidhje me kuptimin dhe me kufijtë e nenit 84 (g) të Kushtetutës, Gjykata thekson se kërkesat e parashtruara mbi këtë bazë mund të jenë të pranueshme vetëm brenda juridiksionit të rregullt të Gjykatës, të përcaktuar shprehimisht dhe qartë në nenin 113, paragrafët 2 dhe 3."

73 **Rasti KO 79/18**: paragrafët 79-83.

Ajo që duhet vënë në dukje këtu është se rasti u shpall i papranueshëm për shkak se **Presidenti i Republikës** nuk posedon **legjitimitet aktiv** për t'u paraqitur palë në procedurë jashtë rasteve nga neni 113 pikat 2 & 3 të Kushtetutës. Përkundër kësaj, Gjykata hyri në shtjellime meritore të rastit, duke theksuar se nuk bie në kompetencë kushtetuese të Presidentit emërimi i anëtarëve të **KQZ,** por vetëm emërimi i kryetarit të këtij organi dhe se kjo nuk përbën çështje kushtetuese në kuptim të nenit 113 pikat 1 dhe 2 të Kushtetutës.[74] Kjo pikëpamje është e pavend për dy arsye: e para, sepse rasti u shpallë i papranueshëm për shkak të mungesës së **legjitimitetit aktiv** nga ana e Presidentit; dhe, e dyta, sepse **dekretimi** i anëtarëve të **KQZ** bëhet nga Presidenti, para të cilit ata edhe japin. Kjo do të thotë se nuk ka asnjë rëndësi nëse një kompetencë e tillë përshkruhet me ligj për anëtarët tjerë të **KQZ**: në fund, caktimi i tyre është në kompetencë të **Presidentit të Republikës**. Përveç kësaj, këtu bëhet fjalë për një organ kushtetues që normohet me nenin 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve] të Kushtetutës. Një gjë e tillë nënkupton se, për pasojë, akti me të cilin materializohet kompetenca e Presidentit për caktimin e anëtarëve të rinj të **KQZ** ka formën dhe fuqinë juridike të një **dekreti** të Presidentit të Republikës, që normohet me Kushtetutë dhe jo me ligje. Shih për këtë, nuk është i qëlluar konstatimi në paragrafin 83 të Aktgjykimit, ku Gjykata ka ardhur në përfundim se çështja e ngritur nga Presidenti nuk paraqet çështje kushtetuese në kuptim të nenit 113 pikat 2 & 3 të Kushtetutës.[75] Ky nen nuk bën fjalë për çështje kushtetuese por për kontroll kushtetues të akteve dhe veprimeve juridike dhe mosveprimeve të një formati dhe përmbajtje të caktuar.

Asnjëra prej kompetencave të juridiksionit kushtetues nga neni 113 i Kushtetutës nuk përbën çështje kushtetuese. Aty bëhet fjalë për akte, veprime e mosveprime të natyrës juridike, brenda të cilave ngërthehen marrëdhëniet që kanë natyrë juridiko-kushtetuese. Në rastin konkret, në momentin që Gjykata ka konstatuar se Presidenti nuk ka **legjitimitet aktiv**, ka qenë dhe është absurd çdo shtjellim i juridiksionit nga neni 113 i Kushtetutës me qëllim që të tregohet nëse emërimi i anëtarëve të **KQZ** përbën një çështje kushtetuese që hyn në kuadër të kompetencave të Presidentit. Kjo për shkak se nxjerrja e **dekreteve** nga ana e Presidentit është një kompetencë kryesore e shefave të shteteve, pa marrë parasysh sistemin e qeverisjes. Nuk ka asnjë rëndësi që për disa **dekrete** mund të ketë bazë në ndonjë ligj tjetër, jo në kushtetutën nacionale. Kjo do të thotë se këtu ka rëndësi forma dhe fuqia juridike e aktit, e cila përcaktohet me Kushtetutë. Me **dekrete** Presidenti materializon kompetencat e veta kushtetuese, një nga një. Kjo është vetë esenca e kompetencave nga neni 113 pikat 2 dhe 3 në lidhje me nenin 84 [Kompetencat e Presidentit] të Kushtetutës. Nuk ka rëndësi këtu që Presidenti gabimisht e ka cilësuar në aspektin juridik të drejtën e tij për t'iu drejtuar Gjykatës duke u bazuar në nenin 84.9 të Kushtetutës. Ajo që ka rëndësi lidhet me kompetencat e tij dhe formën juridike të materializimit të tyre, ku dekreti dhe dekretimi dominon si formë. Në fund të fundit, Gjykata nuk është e lidhur me cilësimin juridik që një palë ia bën të drejtave të tij dhe bazës për ngritje të një kërkese pranë saj.

T'i kthehemi sërish rastit **VLAN I** dhe esencës së argumentit kushtetues aty, si në formë ashtu dhe në përmbajtje.

Bazuar në këtë interpretim si më sipër për rastin **VLAN I** janë bërë kryeministër pas zgjedhjeve të mëpastajme nacionale, përfshirë dhe ato të 8 qershorit 2014, një pas një, krejt liderët e opozitës që vetë e kundërshtonin një vendim të tillë, duke identifikuar atë interpretim ekskluzivisht me autorin e parë të këtij libri. Ky autor, ndërkaq, në konferencën e fundit për shtyp me rastin e përfundimit të mandatit të dytë dhe të fundit si kryetar i gjeneratës së parë të **GJKRKS** e kishte bërë të qartë se koha do të dëshmonte qëndrueshmërinë e vendimit në rastin **VLAN I**, përkatësisht se do të dëshmohej katërçipërisht profesionalizmi i **GJKRKS** do t'i qëndrojë kohës për aq sa ekziston

[74] **Rasti KO 79/18**: Paragrafi 80.

[75] **Rasti KO 79/18: "[…] 83.** Prandaj, bazuar në atë që u tha më lart, Gjykata gjen se çështjet e ngritura nga parashtruesi para Gjykatës nuk hyjnë në fushëveprimin e juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese, siç përcaktohet me nenin 113. Rrjedhimisht, në pajtim me nenin 113, paragrafi 1, të e Kushtetutës, Gjykata përfundon se kërkesa është e papranueshme."

sistemi aktual proporcional i zgjedhjeve në Kosovë ku njëzet (20) vendet jo shqiptare kanë njësinë e tyre zgjedhore që deformon përqindjen e votave totale të fituara të popullsisë shqiptare si komunitet shumicë në vend.[76]

Bllokada e opozitës për formimin e organeve zgjati, siç u tha, më shumë se pesë muaj. Kjo nisi në fillim me bllokimin e formimit të Kuvendit të Kosovës më datën 17 korrik 2014. Këtë ditë, opozita nisi në mënyrë arbitrare formimin e këtij organi kushtetues, duke uzurpuar postin e kryetarit të tij. **Opozita nuk çante fare kokën për të parë prerogativën e qartë kushtetuese që i jep të drejtë ekskluzive vetëm fituesit relativ të zgjedhjeve nacionale për të propozuar kandidatin për kryetar të Kuvendit dhe mandatarin e ri për formimin e Qeverisë, duke e ngatërruar këtë aspekt kushtetues me çështjen se kush komandon më shumë vota në Kuvend për t'u zgjedhur në këto dy poste (kryetar Kuvendi dhe kryeministër i Qeverisë).**

Tërë ky bllokim i Kuvendit ka ndodhur në vigjilje të hapjes së sesionit të parë inaugurues të **Kuvendit të Kosovës**, kohë gjatë së cilës opozita insistonte se kishte më shumë deputet se fituesit e zgjedhjeve nacionale. Duke ndjekur këtë logjikë, ata nuk dëshironin fare të dinin për ekzistimin e rregullave të procedurës (rregullat e brendshme) në Kuvendin e Kosovës, të cilat kërkonin nga çdo seancë inauguruese e tij të ndiqte një rrugë të caktuar me rastin e konstituimit fillestar. Kjo nënkuptonte, në rend të parë, që opozita nuk po qante kokën për dhënien e betimit të deputetëve të saj dhe deputetëve të tjerë që ishin zgjedhur me votat e qytetarëve të Kosovës. Betimi i deputetëve, ndërkaq, përbën aktin themelor individual që hap rrugën për konstituim të organit përfaqësues dhe aktivizon mandatet e deputetëve.[77] Ata nga opozita nuk kuptonin se numri i votave që një parti apo koalicion i ka fituar në zgjedhje nuk përbën një çështje kushtetuese. Një gjë e tillë përbën çështje të pastër politike që reflekton balancin politik brenda organit përfaqësues dhe ligjvënës – Kuvendit. Ky organ kushtetues, në anën tjetër, konsiderohet se është i formuar (konstituar) atëherë kryhet zgjedhja e kryetarit dhe pesë (5) nënkryetarëve.[78] Kjo është praktikë standarde në shumicën e vendeve që kultivojnë demokraci kushtetuese parlamentare me kryetar të zgjedhur nga parlamenti nacional.[79]

Nuk diskutohet që ekzistojnë norma të ndryshme kushtetuese dhe juridike që rregullojnë inaugurimin e organit legjislativ pas certifikimit të zgjedhjeve nacionale. Disa nga to parashikojnë zgjedhjen me më shumë kandidat dhe me votim të fshehët, kurse të tjerat parashikojnë nominimet në mesin e anëtarëve të organit legjislativ ashtu që ai që fiton shumicën e zgjedh kryetarin e këtij organi dhe përfaqësuesit e tjerë. Rregull themelor është që, megjithatë, normat që rregullojnë inaugurimin e organit legjislativ pas zgjedhjeve të përgjithshme janë të paracaktuara dhe të ndërtuara që më parë ashtu që ato nuk mund të ndryshohen aty për aty në vigjilje të zgjedhjeve për kryetar dhe struktura tjera të organit legjislativ.[80] Zgjedhja e kryetarit të legjislativit të ri konsiderohet si një proces i pandashëm nga formimi (inaugurimi) i të njëjtit. Kjo është kështu për një arsye fare të thjeshtë: deri në formimin apo inaugurimin e legjislativit të ri, i njëjti organ nuk paraqet trupë funksionale përfaqësuese në nivel nacional me pushtet për të nxjerr ligje dhe marrë vendime të tjera të vlefshme në kuadër të kompetencave të tij kushtetuese.

---

[76] Në zgjedhjet e fundit, datë 6 tetor 2019, **Albin Kurti** nga **LVV** doli fitues i zgjedhjeve nacionale dhe u bë kryeministri i tretë me radhë që përfiton nga vendimet e Gjykatës për **Rastin e Ngërçit** (pas **Isa Mustafës**: 2014 – 2017 dhe **Ramush Haradinajt**: 2017-2019); Për konferencën për shtyp të ish-kryetarit të **Gjykatës Kushtetuese**, autorit të parë të këtij libri, cf. në 'Enver Hasani e përfundon mandatin në Gjykatën Kushtetuese'. **KLAN KOSOVA** 20:22, 16 qershor 2015. Në internet: https://klankosova.tv/enver-hasani-e-perfundon-mandatin-ne-gjykaten-kushtetuese-video/ (shikuar në janar 2020).

[77] "Ngjarjet që karakterizuan vitin 2014", **KOSOVAPRESS** 31 dhjetor 2014. Në internet: available at http://www. kosovapress.com/sq/lajme/ngjarjet-qe-karakterizuan-vitin-2014-32251 (shikuar në korrik 2018).

[78] Cf. neni 67 ["[Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] i Kushtetutës.

[79] Në demokracitë kushtetuese liberale, kryetari i organit përfaqësues, parlamentit, zakonisht zgjedhet nga vetë anëtarët e tij. Në historinë e parlamentarizmit, megjithatë, ka raste kur ajo/ai caktohet nga një organ i jashtëm si dhe kur zgjedhja e saj/tij bëhet me votim të drejëpërdrejtë. Për mënrat e zgjedhjet së kryetarit të parlamentit, cf. më shumë në Giovanni Piccirilli, "Il Presidente Provvisiorio". Në Eduardo Gianfrancesco, Nicola Lupo, and Guido Rivosecchi (eds.), *I Presidenti di Assamblea parlamentare* (Il Mulino: Bologna, 2014) fq. 227–252; Stanley Bach, "The office of speaker in comparative perspective". *The Journal of Legislative Studies* Vol. 5 No. 3–4 (1999) fq. 209–254; Georges Bergougnous, *Presiding Officers of National Parliamentary Assemblies* (Inter-Parliamentary Union: Geneva, 1997) fq. 5–45.

[80] Enver Hasani, "The Role of the Constitutional Court in the Development of the Rule of Law in Kosovo" *Review of Central and East European Law* Vol. 43 Issue 3 (2018) fq. 274-313.

Sesioni inaugurues (themelues) ka për qëllim primar bërjen e trupës përfaqësuese funksionale, asgjë më shumë. **Koalicionet paszgjedhore dhe shumicat e formuara më pas nuk kanë implikacione juridiko-kushtetuese në aktin formal dhe simbolik të inaugurimit të legjislativit nacional.** Se kush i ka votat për ta shndërruar propozimin (nominimin) e një kandidati për kryetar të legjislativit nacional në fitues të këtij posti paraqet një çështje thjeshtë politike, e cila duhet të adresohet nga politika dhe nga kushtetutat dhe ligjet nacionale. **E njëjta vlen edhe për postin e kryeministrit në një demokraci kushtetuese parlamentare: individët e mandatuar për postin e shefit të ekzekutivit nacional pas zgjedhjeve të përgjithshme nuk është e thënë se do të jenë të njëjtë me ata që komandojnë shumicën e votave të nevojshme për të marrë postin në fjalë. Kjo e dyta përbën një çështje të pastër të raporteve të forcave politike dhe zgjidhet në terren politik e me mjete politike.**

Ngërçi i krijuar u zgjodh më në fund me 19 nëntor 2014 përmes mjeteve politike: fituesi i më së shumti ulëseve në Kuvend në zgjedhjet e datës 8 qershor 2014, **PDK**, lidhi një marrëveshje koalicioni me **LDK**, partinë e dytë më të madhe në vend (e cila është e njëjtë edhe sot kur shkruhen këta reshta, në zgjedhjet 6 tetorit të vitit 2019).

Në fund publiku kuptoi se presioni ndaj **Gjykatës Kushtetuese** që ajo të gjejë një zgjidhje politike për ngërçin e krijuar, përbënte një qasje absurde që shkonte kundër germës dhe shpirtit të Kushtetutës.[81] Në kuptim të përvojës me sundimin e ligjit, vendimi lidhur me ngërçin u pa sa i efektshëm dhe i qëlluar kishte qenë qysh në zgjedhjet e përgjithshme që pasuan më 11 qershor 2017, kur askush nuk provoi të formojë organet qendrore të pushtetit në mënyrë abritrare siç kishte ndodhur në vitin 2014, por u ndoq në tërësi rruga kushtetuese ashtu siç ishte sqaruar me vendimet e **Gjykatës Kushtetuese** si më sipër. Me pak vonesë, Kuvendi dhe Qeveria u formuan pikërisht në frymën e këtyre vendimeve dhe në respekt të plotë të përcaktimeve kushtetuese. Kjo u pa sërish, bile edhe me dukshëm, më 6 tetor 2019 kur u mbajtën zgjedhjet tjera të përgjithshme. Këtë herë, siç u tha më sipër, për kryeministër u zgjodh **Albin Kurti**, më i zëshmi kundër vendimit të **VLAN**-it, në ndërkohë që në zgjedhjet e vitit 2018 ishte zgjedhur **Ramush Haradinaj**, një tjetër kundërshtues i ashpër i vendimit për rastin **VLAN**. Me fjalë të tjera, në këto dy palë zgjedhje të përgjithshme të vitit 2017 dhe 2019, u krijuan mundësitë për të marrë në duar ekzekutivin pikërisht ata që kishin qenë kundër aktgjykimeve në fjalë të vitit 2014 të **Gjykatës Kushtetuese**. Tani, megjithatë, u bë e qartë për çdokënd se po të ishte ndjekur logjika e përshkruar si më sipër e formimit arbitrar të organeve kushtetuese pas zgjedhjeve nacionale, atëherë me siguri që vendi do të kishte shkuar në kaos dhe anarki. Kjo sepse në një rast të tillë do vinte deri te përmbysja dhe dhunimi i vullnetit të qytetarit, i shprehur në kutitë e votimit, ashtu që rruga dhe pazaret e saj do ta përcaktonin atë vullnet të sovranit.

16.6. Rasti "Banka Raiffeisen"

Në këtë seksion nuk diskutojmë vetëm rastin që mban titullin e tij, por edhe dy raste të tjera që konceptualisht ndërlidhen me të. Rastet në dritën e të cilave e diskutojmë këtë rast, janë vendosur nga **GJSK** (rasti i një aktgjykimi që lidhet me zgjedhjet nacionale të datës 6 tetor 2019) dhe nga Gjykata Kushtetuese

[81] Në periudhën pas zgjedhjeve të datës 8 qershor 2014 e deri në zgjidhjen e ngërçit më 19 nëntor 2014, ka ndodhur një presion i paparë, intimidim dhe kërcënim kundër gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, në rend të parë kundër kryetarit të saj, autorit të parë të librit. Një gjë e tillë ka qenë si rezultat i një shprese fiktive që kanë ushqyer disa se përmes presioneve dhe kërcënimeve do të ndikohej vendimmarrja e Gjykatës, në kundërshtim me Kushtetutën dhe normat e saj të qarta që rregullojnë inaugurimin (formimin) e Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës pas zgjedhjeve nacionale dhe çdoherë kur shtrohet një nevojë për një formim (inaugurim) të tyre të ri. Është detyrë dhe prerogativë e politikës për të gjetur zgjidhje politike, jo e gjykatave kushtetuese. Për raportimet e medies vendore për kërcënimet dhe presionet si më sipër, cf. më shumë në "Shantazhohet e kërcënohet Enver Hasani, denoncon emra", **TRIBUNA** (24 shtator 2014) fq. 10; "Shantazhohet e kërcënohet Enver Hasani", **LAJM** (24 shtator 2014), fq. 7; "Hasani denoncon kërcënimet ndaj tij", **KOSOVA SOT** (24 shtator 2014), fq. 4; "Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, i shantazhuar e i kërcënuar! Heton policia", **BOTA SOT** (24 shtator 2014), fq. 1–2; "Këndellet Isa Mustafa", **LAJM** (24 September 2014), fq. 7; "Hasani porosit Bllokun: Mos kërcënoni!", **LAJM** (16 tetor 2014), fq. 2; "Hasani: Videoja ka lidhje me aak-në, po më hakmerren për vendimet e Gjykatës", **KOHA DITORE** 25 nëntor 2014, fq. 1–2; "Hasani ndihet i shantazhuar nga politika", **KOSOVA SOT** 26 nëntor 2014, fq. 2; "Policia nis hetimet për skandalin e video-akuzës ndaj Enver Hasanit", **BOTA SOT** 26 nëntor 2014, fq. 1 dhe 4–5; "Enver Hasani, vazhdimisht jam kërcënuar dhe shantazhuar", **BOTAT SOT** 18 dhjetor 2014, fq.18.

(rasti i **Ligjit për Mikrofinanca**).[82] Rasti i Aktgjykimit të **GJSK**[83] ndërlidhet konceptualisht me rastin **Rajfaisen**,[84] për aq sa kjo ka të bëjë me ndërtimin e besimit reciprok në mes të **GJSK** dhe **Gjykatës Kushtetuese**, gjë që ngelet të shihet meqë rasti gjendet në Gjykatën Kushtetuese për vendosje në kohën e shkrimit të këtyre rreshtave (maj 2020). Ai besim ndërtohet më së miri kur secili organ kushtetues ushtron juridiksionin e përcaktuar me Kushtetutë dhe përdorë parametrat e saktë për vlerësimin e kushtetutshmërisë (**Gjykata Kushtetuese**) dhe vlerësimin e ligjshmërisë me kuptim zbatimin unik të ligjit në tërë territorin e Kosovës (**GJSK**). Historikisht shikuar, juridiksionet në mes të gjykatave supreme dhe gjykatave kushtetuese kanë nisur të ngatërrohen pas Luftës së Dytë Botërore kur kushtetutat nisën të shihen si instrumente normative me mekanizma gjyqësor për vënien e tyre në jetë, njëjtë siç ndodh me ligjet dhe aktet tjera të përgjithshme. Në fillim, mosmarrëveshjen nisën në sferën e zgjidhjes së rasteve kushtetuese përmes procedurave për kontroll incidental, për të kulmuar në mënyrë të veçantë me futjen në përdorim të ankesës kushtetuese. Futja e saj në kuadër të mekanizmave kushtetues gjyqësorë për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut ka qenë dhe ngelet shkaku kryesor i keqkuptimeve në mes të gjykatave kushtetuese dhe gjykatave supreme. Kjo për faktin se korpusi i lirive dhe të drejtave kushtetuese që u fut në kushtetutat nacionale, me garancionet për vënien e tyre në jetë përmes gjyqësisë kushtetuese, përbëhej nga dispozita të përgjithshme që ngërthenin koncepte e parime të së drejtës natyrore të mbingarkuara me gjykime e konotacione të forta të karakterit moral.[85] Në këtë kuptim, as Kosova nuk bën përjashtim: Kushtetuta përmban dispozita mbi liritë dhe të drejtat e njeriut që janë të grumbulluara në dy kapituj, njëri prej të cilëve është shumë specifik dhe lidhet me rrethanat historike të ndërtimit të shtetit të Kosovës. Kjo reflektohet në praktikën gjyqësore të **GJSK** por edhe të **Gjykatës Kushtetuese**. Në fakt, në këtë të fundit, mbi 90 për qind e krejt ngarkesës e përbëjnë rastet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut nga kapituj II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre] të Kushtetutës.

Se interpretimi i dispozitave mbi liritë dhe të drejtat kushtetuese përbën një sfidë të veçantë, më së miri shihet nga rasti që kemi përzgjedhur për diskutim, i vendosur nga GJSK. Kjo sfidë ekziston edhe në vendet tjera dhe, siç u tha, lidhet me vetë konceptin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të natyrës juridike të kushtetutës nacionale, e cila tani shihet si një akt normativ që zbatohet me anë të mekanizmave gjyqësorë njëjtë si çdo akt tjetër i përgjithshëm. E kemi fjalën këtu për rastin e **Aktgjykimit të GJSK** të dhënë lidhur me zgjedhjet nacionale.

Sa i përket lidhshmërisë konceptuale të rastit **Rajfaisen** me rastin e **Ligjit për Mikrofinanca**, rasti **Rajfaisen**, ajo i referohet vetëm një dimensioni: në dy rastet Gjykata Kushtetuese ka shërbyer si gardian i Kushtetutës duke penguar pasurimin pa bazë të subjekteve të caktuar të së drejtës, përmes shfrytëzimit të situatave joligjore për pasurim.

Ndërlidhja konceptuale ndërmjet vete të tri rasteve i referohet brendisë së fakteve jetësore mbi të cilat janë ndërtuar ato. Fjalën e kemi, në rend të parë, me faktin se në dy prej tri rasteve që diskutohen në këtë seksion janë përdorur konceptet e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut si parametër për kontroll kushtetues të akteve juridike dhe veprimeve të caktuara të individëve. Në vijim të kësaj, në rend të dytë, faktet e dy rasteve lidhen me ruajtjen e individëve nga eksploatimi i pamëshirshëm i tregut të pakontrolluar financiar dhe tregtar. Të parat fakte kanë lindur gjatë zgjedhjeve të fundit nacionale në Kosovë dhe

---

82 *Rasti KO 97/12. Aktgjykim. Parashtrues: Avokati i Popullit. Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve: 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116, të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë: 12 prill 2013. Nr. ref.: AGJ403/13.

83 *Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës AA Uzh nr.20/2019 i datës 30.10.2019* (**Aktgjykimi i GJSK**).

84 *Rasti KI 118/14. Aktvendim. Parashtrues: Raiffeisen Bank Kosovo J. S. C. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 24/2013, të 5 shkurtit 2014.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtine: 9 mars 2015. Nr. ref.: RK 777/15.
Cf. paragrafët 55-84 të Aktvendimit në rastin **KI 118/14.**

85 Lech Garlicki, "Constitutional courts versus supreme courts" *International Journal of Constitutional Law* Volume 5 Number 1 (2007) fq. 44–68 në fq.46-49.

janë vlerësuar (në mënyrë të gabuar) në një vendim meritor të **GJSK**. Përmes vlerësimit të fakteve lidhur me zgjedhjet nacionale, GJSK interpretoi Kushtetutën në mënyrë të papranueshme dhe jashtë mandatit të saj kushtetues.

Faktet e llojit të dytë i takojnë rrethanave që kanë lindur dhe që përbëjnë rastin kushtetues që mban titullin e këtij seksioni, si dhe një rasti tjetër që ka të bëj me kontrollin kushtetues të normës abstrakte, ku **Gjykata Kushtetuese** me shumë guxim dhe kompetencë ka anuluar një ligj që për synim kryesor kishte shfrytëzimin e djersës së tjerëve për përfitime kolosale ligjërisht të dyshimta. Përveç përfitimeve kolosale të djersës së tjerëve, siç do të shihet, normat abstrakte (të **Ligjit për Mikrofinancat**), cenonin edhe dispozitat tjera kushtetuese që kanë të bëjnë me sigurinë juridike,[86] cenimin e elementeve themelore të demokracisë,[87] të drejtës për asocim, të drejtës së pronës dhe ekonomisë dhe, në fund, me vetë kuptimin e lirisë së tregut dhe tregut të lirë.[88]

Rasti **Rajfajsen** është zgjedhur me aktvendim, me të cilin Gjykata Kushtetuese ka vërtetuar një vendim të **GJSK**. Në praktikën e **Gjykatës Kushtetuese**, siç e kemi thënë më herët në seksionin **11.1** të kapitullit të njëmbëdhjetë, thuajse mbi 90 për qind të vendimeve janë aktvendime që vërtetojnë (konfirmojnë) vendimmarrjen e GJSK, përkatësisht që konstatojnë se vendimmarrja e tilla e saj lëvizë brenda parametrave të përcaktuar kushtetues. Ky rast që diskutohet këtu nuk bën përjashtim.

Rasti në fjalë, i shpallur si qartazi i pabazuar dhe, si i tillë, i papranueshëm, ka pasur të bëj me këtë: kërkuesi, **Banka Rajfajsen**, kishte humbur kontestin civil në të gjitha shkallët e gjyqësorit Kosovar. Ai kishte kërkuar që Gjykata Kushtetuese të anulonte vendimin e **GKS**, që kishte konstatuar, njëjtë si shkallët tjera të gjyqësorit kosovar, se **kamata ndëshkuese** për shkak të vonesave në shlyerjen e borxhit kryesor nuk mund të kontraktohej në pagesat në të holla. Për detyrimet në të holla, **kamatat ndëshkuese** kanë qenë dhe janë të përcaktuara sipas ligjit, jo përmes kontratës në mes të palëve. Kjo për shkak se, një gjë e tillë do të përbënte pasurim pa bazë juridike, siç kishin konstatuar me të drejtë të gjitha instancat e gjykatave të rregullta në Kosovë.[89]

Me këtë vendim, që ka strukturën e pjesës dërrmuese të vendimeve në vitet 2009-2015 me të cilat rastet shpalleshin të palejueshme për shkak të pabazueshmërisë së qartë të argumenteve,[90] **Gjykata Kushtetuese** ka ndërtuar një raport të besimit reciprok me **GJSK** duke vërtetuar se ekziston, sipas termave kushtetues, një ndarje e rreptë e punëve në mes të dy institucioneve, ku Gjykata Kushtetuese kujdeset për vënien në jetë të normave dhe parimeve të Kushtetutës. E thënë me fjalë të tjera, parametrat për vlerësim juridik të çështjes dallojnë dukshëm në procedurat pranë njërës dhe tjetrës gjykatë: çdoherë kur bënë kontrollin kushtetues të vendimeve të **GJSK,** Gjykata Kushtetuese zbaton Kushtetutën e vendit si akt me fuqi më të lartë normative në mënyrë të drejtpërdrejtë. **GJSK**, ndërkaq, në këtë ndarje të rreptë të punëve kujdeset për zbatimin unik dhe të drejtpërdrejtë të ligjeve në tërë territorin e vendit. **Kushtetutshmëria e ligjeve çdoherë prezumohet.** Në këtë kuptim duhet parë detyrimin kushtetues që thotë se gjykatat e rregullta gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit. Nisur nga prezumimi i kushtetutshmërisë së ligjeve, kur gjykatat e rregullta bëjnë zbatimin e tyre, atëherë në të njëjtën kohë ato zbatojnë edhe Kushtetutën, jo në mënyrë të drejtpërdrejtë por përmes zbatimit të ligjeve që prezumohet se janë kushtetuese deri sa mos të sfidohet një cilësi e tillë e tyre.[91] Kjo nuk duhet të kuptohet si një detyrim kushtetues që nënkupton

---

86 **Rasti KO 97/12.** Paragrafët: 126-130.

87 **Rasti KO 97/12**. Paragrafët: 132-133.

88 **Rasti KO 97/12.** Ibid., paragrafët: 134-137.

89 **Rasti KI 118/14**. Paragrafët: 55-84.

90 Struktura e argumenteve kushtetuese me një rresht që ka natyrë përfundimtare (që e mbyllë argumentin e parashtruar me qëllim të vërtetimit të fakteve kushtetuese), i njohur ndryshe si **rrathët lidhës zinxhiror**, e dominon narrativin e këtij vendimi. Kjo strukturë, siç e kemi theksuar në kapitullin paraprak, seksioni **15.3**, cilësohet nga një sër premisash dhe përfundimesh të ndërvarura që formojnë një argument të qëndrueshëm në vetvete në mënyrë të pavarur.

91 Kapitulli VII Sistemi i Drejtësisë. Neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] i Kushtetutës: "[…] 3. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit".

se gjykatat e rregullta posedojnë tagrin për të bërë zbatimin e drejtpërdrejtë të normave kushtetuese, e aq më pak t'i interpretojnë ato për qëllimet e zbatimit të drejtpërdrejtë me rastin e zgjidhjes së rasteve dhe mosmarrëveshjeve konkrete. E thënë me fjalë të tjera, gjykatat e rregullta nuk mund t'i interpretojnë normat kushtetuese për qëllimet e zbatimit të tyre si bazë e vetme juridike për vendimmarrjet e tyre, duke përjashtuar tërësisht normat ligjore. Kjo është kështu sepse janë normat ligjore ato që gjykatat e rregullta e kanë për detyrim primar që t'i interpretojnë për qëllim të zbatimi gjatë gjykimeve të rasteve dhe mosmarrëveshjeve konkrete. Kjo është kështu edhe në vendet tjera që i takojnë modelit **evropian/kelsenian** të gjyqësisë kushtetuese.[92] Një ndarje e tillë e punëve duhet parë në kuadër të konceptit mbi fizionominë e përgjithshme të gjyqësisë kushtetuese dhe gjyqësisë së rregullt: e para ka për mision primar sigurimin e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës, duke përdorur parametra të qartë kushtetues, kurse e dyta ka për qëllim primar sigurimin e supremacisë (epërsisë) së ligjeve dhe zbatimin e tyre unik për tërë territorin nacional. Monopolin e interpretimit të Kushtetutës për qëllimet e zbatimit të dispozitave të saj e ka vetëm Gjykata Kushtetuese kurse gjyqësori i rregullt, i të gjitha niveleve, ka për detyrim interpretimin e ligjeve për qëllim të zbatimit të tyre me rastin e zgjidhjes së rasteve dhe mosmarrëveshjeve konkrete. Interpretimi i Kushtetutës për qëllim të zbatimit të saj në një rast apo mosmarrëveshje konkrete nuk mund të jetë asnjëherë ingerencë e gjyqësorit të rregullt. Ky gjyqësor kur bën interpreton ligjet me qëllim të zbatimit të tyre të drejtpërdrejtë gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe në respektim të dispozitave të saj, krejt kjo si pasojë e prezumimit të kushtetutshmërisë së ligjeve. Çdoherë kur ndeshet me dilema lidhur kushtetutshmërinë e ligjeve që duhet t'i zbatoj, gjyqësori i ka të drejtë për të iniciuar procedurat e **kontrollit incidental**. Kjo procedurë është paraparë pikërisht për të ruajtur ndarjen e punëve në mes të gjyqësorit të rregullt dhe gjyqësisë kushtetuese dhe, në fakt, përbën mbetje të sistemit amerikan të gjyqësisë kushtetuese që ekziston në të gjitha vendet që kultivojnë modelin evropian/kelsenian të gjyqësisë kushtetuese. Ruajtja dhe kultivimi i kësaj procedure në modelin evropian/kelsenian ka shërbyer, në të njëjtën kohë, si shkak dhe arsye e ngatërresave e mosmarrëveshjeve në mes të dy juridiksioneve. Këtë më së miri e shpërfaq historia e gjyqësisë kushtetuese italiane dhe mosmarrëveshjet e ashpra ndërmjet Gjykatës Supreme të Kasacionit dhe Gjykatës Kushtetuese.

Krahas kontrollit incidental, futja e **ankesës kushtetuese** në mekanizmat e gjyqësisë kushtetuese, po ashtu ka kontribuar në ngatërrim të kompetencave në mes të dy juridiksioneve. Ky ngatërrim, megjithatë, vetëm në dukje është i tillë: efektivisht, gjyqësia kushtetuese mbikëqyrë kushtetutshmërinë e procedurave të zhvilluara pranë gjyqësorit të rregullt, nëse të njëjtat janë të përlyera me shkelje kushtetuese, duke mos ndërhyrë asnjëherë në analizën e fakteve origjinale jetësore të rastit apo mosmarrëveshjes konkrete ashtu siç janë prezantuar ato në instancat relevante të gjyqësorit të rregullt. Në gjyqësinë kushtetuese analizohen dhe vlerësohen vetëm faktet kushtetuese, ashtu siç janë prodhuar ato në procedurat pranë të gjitha instancave të gjyqësorit të rregullt. Në gjyqësorin e rregullt, ndërkaq, gjendja është e njëjtë vetëm sa i përket fakteve origjinale ashtu siç janë prodhuar ato në procedurat pranë këtij gjyqësori. Kjo është arsyeja pse në procedurat sipas ankesave kushtetuese nuk mund të ekzistojë juridiksioni origjinal i gjykatave kushtetuese, gjë që nënkupton se si juridiksion u takon gjykatave të rregullta në instancë të parë, duke humbur gradualisht për t'u zhdukur fare në instancën e fundit të këtij gjyqësori (i cili kryesisht merret me anën juridike të rastit dhe mosmarrëveshjes). U mor vesh, këtu bën përjashtim rasti i atyre vendeve që kultivojnë **actio popularis**, ku mund të sfidohet akti juridik nga secili subjekt juridik.

Sikundër shihet, instanca e fundit e gjyqësorit të rregullt në nivel nacional ka shumë pak juridiksion origjinal sa i përket anës faktike. Kjo është kështu edhe me GJSK, e cila kryesisht kujdeset për zbatimin unik të ligjit në nivel vendi. Kjo situatë, jo rrallë ngatërrohet në praktikë, ashtu që gabimisht veprohet, duke ngatërruar juridiksionin e gjyqësisë së rregullt dhe të gjyqësisë kushtetuese, pikërisht mbi bazën e postulatit të vënë në shumicën e kushtetutave të vendeve demokratike. Sipas këtij postulati, që u cek më

[92] Kjo ndryshon në vendet e sistemit të së drejtës së përgjithshme. Këtu në veçanti kemi parasysh **Gjykatën Supreme të SHBA**. Sikundër dihet, kjo Gjykatë ushtron juridiksion kushtetues në shkallë të fundit, por si pjesë e zgjidhjes së një rasti apo mosmarrëveshjeje konkrete, dhe zbaton në mënyrë të drejtpërdrejtë e merr një normë kushtetuese apo precedent kushtetues si bazë të vetme dhe ekskluzive për vendimmarrje. Kjo nuk dallon në thelb as ne vendet tjera të sistemit të përgjithshëm ku juridiksioni kushtetues ushtrohet si pjesë përbërëse e një zgjidhjeve apo vendosjeje lidhur me një rast apo mosmarrëveshje konkrete.

sipër, gjykatat gjykojnë sipas kushtetutës dhe ligjit. Se çfarë do të thotë kjo e sqaruam më sipër. Këtu do të shtjellojmë ekskluzivisht situatën e ngatërrimit që **GJSK** ia ka bërë juridiksionit të saj themelor, duke e marrë rolin e një gjykate kushtetuese në vendosjen për ligjshmërinë e votave të ardhura nga diaspora. Në këtë rast, ajo ka vendosur sipas ankesës së **LVV.** Në këtë rast, siç u tha dhe siç do të sqarohet në rreshtat në vijim, **GJSK** ka vepruar si gjykatë kushtetuese, duke keqkuptuar në tërësi detyrimin nga neni 102.3 i Kushtetutës. Të shohim këtë më nga afër.

Ky keqkuptim i mesazhit të nenit 102.3 të Kushtetutës ankorohet në faqen e tretë të Aktgjykimit dhe lidhet me pozitën dhe fuqinë juridike të **marrëveshjeve ndërkombëtare** në rendin juridik kosovar. Esenca e ngatërrimit konsiston në atë se **GJSK** nuk ka arritur të bëj dallimin në mes të instrumenteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare nga neni 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe i atyre që lidhen sipas nenit 19.2 [Zbatimi i të Drejtës Ndërkombëtare] të Kushtetutës. Në faqen 3, paragrafi dytë, të Aktgjykimit të **GJKS**, në mënyrë arbitrare janë interpretuar dispozitat kushtetuese të nenit 22 të Kushtetutës, duke u ngatërruar me ato nga neni 19.2. Kjo ka ndodhur jo në procesin e interpretimit të ligjit me qëllim zbatimi, por me qëllim të anashkalimit të zbatimit të tij, duke u thirrur nga ana e **GJSK** në mbrojtjen e supremacisë (epërsisë) së normave kushtetuese. Për shkak të rëndësisë dhe me qëllim të qartësimit për lexuesin, në vazhdim e japin në tërësi pjesën ku **GJSK** bën këtë evazion të zbatimit të ligjit në emër të zbatimit të drejtpërdrejtë të normave kushtetuese, si norma më supreme se ligji, duke arsyetuar si vijon:

"[...] Me nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është përcaktuar zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare, në rast konflikti ndaj dispozitave ligjore dhe akteve të tjera të institucioneve publike, ndër të tjera edhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet e saj, andaj Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se konkludimi juridik i PZAP-it se apeli i paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) është i pabazuar dhe bie ndesh me Protokollin 1 – neni 3 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo nga fakti se me konkludimin e PZAP- së se dorëzimi i fletëvotimeve për të cilat është ushtruar apeli, që janë pranuar pas ditës së zgjedhjeve, të datës 06.10. 2019, janë të pasafatshme, është në kundërshtim me nenin e cekur i cili garanton të drejtën për të votuar dhe të drejtën për tu zgjedhur. Parimi i votimit universal është shumë i fortë dhe shtetit i kërkohet në mënyrë shumë strikte të justifikoj humbjen e votës nga individë ose kategori të caktuar personash. [...]"

Me këtë formulim, shihet qartë se **GJSK** nuk e kupton se dispozitat kushtetuese të nenit 22 të Kushtetutës kanë fuqi të njëjtë kushtetuese sikur krejt dispozitat tjera, gjë që nënkupton se funksioni i kësaj dispozite kushtetuese nuk është që të autorizoj shmangien e zbatimit të ligjeve pozitive të Kosovës. Si e tillë, dispozita ka kuptimin e detyrimit të shtetit të Kosovës për të garantuar vënien në jetë të lirive dhe të drejtave të garantuara me ato marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare që përmenden aty. Mënyra si ka arsyetuar **GJSK** është arbitrare për shkak se, thjeshtë, Kushtetuta fare nuk autorizon asnjë organ tjetër shtetëror, përfshirë **GJSK**, për të mënjanuar apo shmangur zbatimin e ligjeve kur ato bien në kundërshtim me normat kushtetuese. Në një rast të tillë, pra kur gjykatat vijnë deri të një konstatim se ligji apo norma që duhet ta zbatojnë është kundër kushtetuese, atëherë ato kanë vetëm një autorizim – inicimin e procedurave të kontrollit incidental sipas nenit 113.8 ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] të Kushtetutës. Kjo është kështu në Kosovë dhe në krejt vendet e modelit **evropian/kelsenian**, siç e kemi sqaruar disa herë në kapitujt e parë të librit dhe siç e sqaruam më sipër në këtë seksion. Në vendet e sistemit të së drejtës së përgjithshme, apo në vendet me sistem **hibrid** (të përzier) të gjyqësisë kushtetuese, një veprim si ky i **GJSK** lejohet, por vetëm sa i përket niveleve më të ulëta të gjyqësorit të rregullt: secili gjyqtar që mendon dhe dyshon se një normë juridike që duhet ta zbatoj në një rast apo mosmarrëveshje konkrete është jo kushtetuese, ka të drejtë ta mënjanoj (shmang) atë duke mos e zbatuar në rastin apo mosmarrëveshjen konkrete. Më pastaj, si çështje kushtetuese, së bashku me çështjen apo mosmarrëveshjen konkrete, rasti mund të përfundojë në instancën më të lartë gjyqësore në vend dhe të zgjidhet atje, por gjithnjë si pjesë e rastit apo mosmarrëveshjen konkrete.

Ajo siç ka vepruar **GJSK** në përshkrimin si më sipër përbën arbitraritetin e parë, për shkak se ajo nuk e ka kuptuar se dispozitat e nenit 22 të Kushtetutës kanë fuqinë e normave kushtetuese, dhe jo të instrumenteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare që kanë fuqi më të lartë se ligjet pozitive të Kosovës, por me të ultë se Kushtetuta, në kuptim të përcaktimit të nenit 19.2 ["Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare"] të Kushtetutës. Nëse ka pasur dyshim në kushtetutshmërinë e **Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës** (LZP),[93] atëherë **GJSK** është dashur të ndërpres procedurat dhe të dërgojë rastin në Gjykatën Kushtetuese për **kontroll incidental**, jo të bëjë shmangien e zbatimit të tij, siç ka bërë në një mënyrë arbitrare. Ky arbitraritet, e thënë me fjalë të tjera, shprehet në faktin se **GJSK** në mënyrë arbitrare ka cilësuar si norma ligjore, normat e dispozitës së nenit 3 të Protokollit 1 në KEDNJ, sikur ato të ishin norma të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në kuptim të nenit 19.2 të Kushtetutës. Rolin dhe pozitën e marrëveshjeve ndërkombëtare në sistemin juridik të Kosovës e ka sqaruar Gjykata Kushtetuese në aspektin krahasues në mënyrë të shkëlqyer në një vendim të sajin,[94] nga i cili mund të shihet dallimi në mes të marrë veshjeve të ratifikuara ndërkombëtare dhe marrëveshjeve dhe instrumenteve të tjera që përbëjnë norma të rregullta kushtetuese në kuptim të nenit 22 të Kushtetutës. Me këtë rast, **Gjykata Kushtetuese** ka sqaruar teknikën juridike përmes së cilës marrëveshjet ndërkombëtare bëhen pjesë e sistemit juridik vendor, duke përjashtuar nga kjo teknikë nenin 22 të Kushtetutës. Kjo për arsye se dispozita e nenit 22 ngërthen dhe reflekton vullnetin e sovranit të Kosovës për sa i përket mënyrës së krijimit të detyrimeve kontraktuale ndërkombëtare. E thënë ndryshe, ky vullnet sanksionon procedurën kushtetuese për futjen brenda në sistemin juridik të Kosovës të detyrimeve kontraktuale ndërkombëtare, ndryshe i njohur si procesi i internalizimit të normave ndërkombëtare. Ky fakt kushtetues i bën marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare nga neni 22 krejtësisht të ndryshme prej atyre që lidhen duke ndjekur rrugën e nenit 19.2 i Kushtetutës. Normat e nenit 22 të Kushtetutës janë norma kushtetuese dhe askush nuk mund të vlerësoj nëse një normë ligjore bie ndesh me to, përveç Gjykatës Kushtetuese. Këtë vlerësim të kushtetutshmërisë, megjithatë, e ka bërë **GJSK** në mënyrë krejtësisht arbitrare. Kjo shihet jo vetëm nga paragrafi i cituar si më sipër i Aktgjykimit, por edhe nga arsyetimi në faqen e njëjtë, ku është thënë si vijon:

"[...] Duke u bazuar në një gjendje të tillë të çështjes, rezulton konkludimi juridik se neni 96 para 2 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës dhe nenit 4 të par. 4 i Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013 janë në kolizion me nenin 3 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut i cili përfshin të drejtën për zgjedhje të lira, dhe në rastin konkret votuesit pa fajin e tyre ishin privuar nga mundësia për të shprehur mendimin e tyre në lidhje me zgjedhjen e anëtarëve të Parlamentit të Republikës së Kosovës, votuesve iu është mohuar vetë thelbi i së drejtës për të votuar, siç garantohej nga neni 3 i Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut [....]."

Nga ky arsyetim qartë del arbitrariteti i dytë me radhë i **GJSK** që konsiston në faktin se ajo nuk e ka kuptuar natyrën juridike të normës se nenit 3 të Protokollit 1 të **KEDNJ**. Ai nen nuk ka fare të bëj me gjykatat e vendeve që janë palë në KEDNJ, por vetëm me shtetet anëtare. Si i tillë, ky nen ngërthen një detyrim për shtetet palë në KEDNJ për të ndërmarr të gjitha masat e nevojshme për të realizuar të drejtën e përcaktuar në te dhe nuk ka natyrë të vetëzbatueshme, d.m.th. nuk mund të zbatohet drejtpërdrejtë nga gjykatat nacionale sepse nuk ka çfarë të zbatohet aty. Zbatimi i kësaj dispozite ka kuptim vetëm për shtetet anëtare që kanë marrë detyrim për krijimin e të gjitha parakushteve për realizimin e kësaj të drejte. Kosova këtë detyrim e ka realizuar kur ka futur në Kushtetutën e vet dispozitën e nenit 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], kur ka nxjerr **LZP** dhe ka ndërtuar krejt infrastrukturën tjetër përcjellëse institucionale dhe financiare për vënien në jetë të detyrimit nga neni 3 i Protokollit 1.

Pjesë e arbitraritetit të dytë si më sipër është edhe arsyetimi i **GJSK**, ku ajo vihet në rolin e mbikëqyrësit të **KEDNJ**. Rolin mbikëqyrës ndaj zbatimit të **KEDNJ** e ka **GJEDNJ**, dhe asnjëherë gjykatat nacionale,

---

93 **Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës** (me ndryshimet dhe plotësimet e tij të kryera me Ligjin nr. 03/L-256) *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* 31/2008 datës 15 qershor 2008 (LZP).

94 Cf. seksionin **16.7.4**, **infra**, në këtë kapitull.

përfshirë **GJSK**. Sikundër u cek disa herë më herët, Kushtetuta në nenin 53 e vë si detyrim për krejt autoritetet publike, jo zbatimin e drejtpërdrejtë të KEDNJ, por detyrimin për të interpretuar dispozitat e saj sipas praktikës gjyqësore të **GJEDNJ**. Këtë nuk e ka bërë **GJSK**, e cila në mënyrë arbitrare ka ushtruar funksionin e mbikëqyrësit të zbatimit të **KEDNJ** në nivel të Kosovës sa i përket zgjedhjeve të fundit nacionale. Këtë mbikëqyrje, ajo e ka ushtruar në mënyrë arbitrare së bashku me një funksion tjetër, që po ashtu nuk i takon me Kushtetutë, kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve, në rastin konkret kontrollin e kushtetutshmërisë së **LZP** duke marr si parametër matës normën kushtetuese nga neni 22 që ka të bëj me **KEDNJ** dhe protokollet e saj. Se kjo është kështu, qartë shihet nga formulimi i nenit 3 të Protokollit 1. Formulimi i nenit 3 të Protokollit 1 është si vijon:

> *"Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër detyrimin për të organizuar zgjedhje të lira në intervale të arsyeshme kohore, me votim të fshehtë, nën kushtet që sigurojnë shprehjen e vullnetit të lirë popullit me rastin e zgjedhjes së ligjvënësve"*

Nga arsyetimi i sipërcituar i GJSK, qartë shihet se bëhet fjalë për interpretim arbitrar, sepse ky nen i Protokollit 1 citohet në kontekst të silogjizmit gjyqësor të paqenë: gjendja faktike që GJSK provon ta subsumoj (nënvë) nën këtë nen të Protokollit 1 ka të bëj me fakte kushtetuese, asnjëherë me fakte ligjore. Vlerësimi i fakteve kushtetuese i takon vetëm Gjykatës Kushtetuese dhe asnjë gjykate tjetër në Kosovë. **GJSK** nuk mund të gjejë as edhe një libër apo komentar mbi KEDNJ që thotë se kjo dispozitë e nenit 3 të Protokollit 1 i dedikohet gjykatave nacionale apo se është e përshtatshme për t'u zbatuar drejtpërdrejtë nga ana e gjykatave nacionale. Përveç kësaj, vlen të theksohet se asnjë prej instrumenteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare nga neni 22 i Kushtetutës nuk ka natyrë të vetëzbatueshme, sepse bëhet fjalë për marrëveshje ndërmjet shteteve si subjekte të së drejtës ndërkombëtare, jo për marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet gjykatave nacionale. Marrëveshjet dhe instrumentet nga neni 22 i Kushtetutës ngërthejnë detyrime të marra nga shtete palë në KEDNJ, me të cilat ato zotohen për vënien e saj në jetë përmes ndërmarrjes së masave legjislative, administrative dhe gjyqësore. Këtë zotim Kosova nuk e ka marrë nuk e ka marr me ratifikim në kuptim të nenit 19.2 të Kushtetutës, por duke i futur një numër të caktuar të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare në nenin 22, si norma kushtetuese, nga ku rrjedh detyrimi i vendit që më pastaj të ndërmerr masat të tjera për operacionalizmin e tyre. Pra, Kosova i ka marrë përsipër detyrimet e tilla që dalin nga ato marrëveshje dhe instrumente që listohen në nenin 22 të Kushtetutës, në një mënyrë të njëanshme.

Ndër masat legjislative bën pjesë nxjerrja e ligjeve speciale apo të veçanta për bërjen të ekzkeutueshme marrëveshjeve dhe instrumenteve nga neni 22 i Kushtetutës. Ndër masat e tilla hyn edhe nxjerrja e **LZP**, kushtetutshmëria e të cilit prezumohet ngaqë asnjëherë deri më sot nuk është kontestuar nga askush në këtë aspekt. Edhe masat administrative, siç janë procedurat në **PZAP,**[95] dhe masat gjyqësore, siç janë procedurat në **GJSK**, mbulohen dhe shkrihen në prezumimin e kushtetutshmërisë përderisa organet kompetente veprojnë në pajtim me **LZP**. Kushtetutshmëria e **LZP** prezumohet sepse është nxjerrë në bazë të Kushtetutës dhe me qëllim të vënies në jetë të lirive dhe të drejtave kushtetuese që kanë të bëjnë me zgjedhjet dhe që ankorohen në nenin 45 të Kushtetutës. E thënë me fjalë të tjera, të drejtat themelore kushtetuese që realizohen përmes zbatimit të **LPZ** përshkruhen në nenin 45 të Kushtetutës. Si i tillë, **LZP** është në funksion të realizimit të këtyre të drejtave specifike dhe krejt të veçanta zgjedhore ashtu që interpretimi i tyre nuk mund të arsyetohet në kombinim me realizimin e lirive dhe të drejtave të tjera të përgjithshme, siç ka bërë GJSK duke përmendur **in abstracto** nenet 31.1 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.[96] Këto dispozita kushtetuese, si dhe mjetet juridike që parashihen aty, duhen kuptuar vetëm në kontekst të mekanizmave juridik dhe institucional që Kosova i ka krijuar me qëllim të vënies në jetë të detyrimit të marrë me nenin 3 të Protokollit 1 të **KEDNJ**. Ato asnjëherë nuk mund të kuptohen si një bazë juridike për vendimmarrje me qëllim të shmangies së zbatimit të **LZP** si ligj pozitiv, siç ka vepruar **GJSK**.

---

[95] Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa. Pune e **PZAP** normohet me kreun XX të LZP.

[96] Cf. Aktgjykimi i GJSK, fq. 3.

Arbitrariteti i fundit dhe më brutal i **GJSK** shprehet në faqen e katërt të Aktgjykimit, ku ajo luan rolin e ligjvënësit sepse anulon afatet e përcaktuara me nenin 96.2 të **LZP** dhe me rregullativën e brendshme të KQZ, të cilat afate prezumohet se janë kushtetuese.[97] Në vend të kësaj, GJSK ka marrë si afat ditën e dorëzimit të votave të diasporës në postë, duke thënë se ato vota janë dorëzuar para afatit kur janë mbajtur zgjedhjet në Kosovë më datën 6 tetor 2019. Duke bërë këtë, GJSK ka imponuar në mënyrë arbitrare afatet e veta imagjinare që janë të zakonshme dhe që gjenden nëpër ligjet e ndryshme të përgjithshme që rregullojnë procedurat gjyqësore në Kosovë (procedurat administrative, civile dhe penale), duke marrë si analogji afatet e tilla për rastet kur individët ndjekin procedurat e caktuara gjyqësore dhe kur dita e vënies në postë të shkresës apo parashtresës merret si ligjërisht e vlefshme. Këto ligje dhe këto afate nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë relevancë në zgjedhje, të cilat normohen me **LZP**. Këtu nuk bëhet fjalë për ruajtjen e afateve për nevoja individuale gjyqësore, por për realizimin e të drejtave kushtetuese zgjedhore që janë të dhëna për t'u shfrytëzuar në kontekstin e proceseve politike zgjedhore. Edhe në ligjet zgjedhore të vendeve evropiane, pa asnjë përjashtim, votat nga jashtë duhet të dërgohen deri në ditën e zgjedhjeve, ose para tyre, dhe asnjëherë pas mbylljes së zgjedhjeve. Këtë interpretim GJSK e ka bërë duke thënë se mospranimi i votave të arritura me vonesë në Kosovë, nënkupton cenimin e nenit 3 të Protokollit 1 në KEDNJ, si dhe neneve 31.1, 32 dhe 54 të Kushtetutës. Sikundër shihet, GJSK nuk ka thënë se mospranimi i votave të arritura nga jashtë Kosovës pas datës 6 tetor 2019 cenon nenin 45 të Kushtetutës (sic!). Ka thënë se janë cenuar nenet 31.1, 32 dhe 54 të Kushtetutës, krejt në mënyrë paushalle sepse, këto nene, siç dihet, nuk kanë asnjë lidhje me zgjedhjet dhe ruajtjen e garantimin e votës së lirë. Me fjalë të tjera, **GJSK** këtu nuk thotë se neni 3 i Protokolli 1 në KEDNJ bie ndesh me nenin 45 të Kushtetutës, por me nenet si më sipër që kanë të bëjnë me realizmin e të drejtave kushtetuese në procedurat individuale pranë organeve shtetërore (sic!). Ky silogjizëm i çuditshëm i një gjendjeje që nuk ka ekzistuar fare ka ndodhur për shkak se GJSK ka caktuar arbitrarisht afateve, duke zbatuar afatet e procedurave të rregullta gjyqësore në procedurat e votimit në nivel nacional, përkatësisht duke konstatuar gabimisht se votat e futura në postë para datës së zgjedhjeve më 6 tetor 2019 duhet të konsiderohen si vota të vlefshme sepse, gjithnjë sipas GJSK, po nuk ku bë kjo, atëherë cenohen të drejtat zgjedhore nga neni 45 i Kushtetutës lidhur me nenin 3 të Protokollit 1 në KEDNJ. Për të shpëtuar këto vota, GJSK ka thirr në ndihmë dispozitat kushtetuese nga neni 31.1, 32 dhe 54 i Kushtetutës, duke zbatuar përmes tyre dispozitat e ligjeve sistemike që vlejnë për afatet gjyqësore dhe administrative, ku afatet ruhen nëse shkresat ose parashtresat e palëve janë dorëzuar në postë brenda afatit të përcaktuar me ligjin përkatës procedural.

T'i kthehemi tani ndërtimit të raportit të besimit në mes të GJKS dhe Gjykatës Kushtetuese, në rastet kur vendimi i kësaj të fundit është meritor, pra anulon vendimet e GJKS.

Gjykata Kushtetuese ndërton raport besimi reciprok edhe kur vendos meritorisht për rastet e vendimeve të **GJSK** që janë objekt i kontrollit kushtetues. Në një rast të tillë vie deri te anulimi i vendimeve të GJSK, apo i vendimeve të gjyqësorit të rregull të një instance më të ulët. Ky raport besimi ndërtohet edhe me gjyqësorin e rregullt, çdoherë kur vendos mritorisht, me aktgjykim. Kjo sepse, në këto raste, kur anulon vendimet e GJKS (apo të gjyqësorit të rregullt), **Gjykata Kushtetuese** jep udhëzime të qarta për mënyrën se si duhet **GJSK** dhe gjykatat tjera të veprojnë me qëllim të sanimit të jo kushtetutshmërisë së gjetur (konstatuar). Kjo nënkupton se **GJSK** dhe gjykatat tjera veprojnë sipas udhëzimeve të dhëna në arsyetimin e aktgjykimit kushtetues me të cilin anulohet vendimi i **GJSK** (apo i gjykatave të tjera të rregullta), ashtu që në vendimmarrjen e dytë **GJSK** (dhe gjykatat tjera të rregullta) detyrohen të marrin në tërësi parasysh udhëzimet në fjalë dhje t'i zbatojnë ato sepse vetëm atëherë konsiderohet se është përmbushur kushti i sjelljes në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin nga ana e GJSK (dhe gjykatave të tjera të rregullta).

---

[97] Në paragrafin e parë të faqes së katërt, **GJSK** ripërsëritë orientimin ligjor që thekson se afati nga neni 96.2 i **LZP** për votat jashtë Kosovës duhet të jetë arritja e tyre në **KQZ** para ditës së zgjedhjeve, kurse sipas rregullativës së brendshme të **KQZ** një afat i tillë është 24 (njëzetë e katër orë) para ditës së zgjedhjeve kur duhet të arrijnë votat nga jashtë **Kosovës**. Në dy rastet bëhet fjalë për afat para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve. Ky është standard edhe i vendeve të tjera perëndimore për sa i përket vlefshmërisë së votave që vijnë nga bota e jashtme.

Efekti juridik i vendimit në rastin **Rajfajzen** ka qenë kolosal sepse me këtë vendim është lënë në vend një vendim thellësisht kushtetues dhe ligjor i GJSK dhe i gjykatave të tjera të rregullta të cilat kishin penguar **shndërrimin e kamatë vonesës në kamatë ndëshkim**, përkatësisht kishin penguar **konstitucionalizimin e fajdes** në mënyrë institucionale. Deri në marrjen e këtij vendimi, qytetarët e Kosovës kanë paguar miliona euro **Bankës Rafajzen** dhe bankave të tjera komerciale. Kjo praktikë tanimë i takon historisë. Ky vendim ka pasur një ndikim të madh sepse ka detyruar sektorin bankar dhe financiar për t'u sjellë sipas kodit të etikës në qarkullimin afarist, bankar dhe biznesor, jo duke shfrytëzuar pozitën e pafavorshme të klientelës kosovare me qëllim të eksploatimit dhe pasurimit pa bazë nga ana e kapitalit bankar dhe financiar.

Përkundër asaj që bëhet fjalë për një procedurë të kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë, rasti i **Ligjit për Mikrofinancat** përbën një tërësi konceptuale me rastin **Rajfajzen**: në dy rastet bëhet fjalë për synimin e kapitalit privat për të gllabëruar djersën e qytetarit të **Kosovës**, pa asnjë kriter dhe ekskluzivisht duke u bazuar në shfrytëzimin e gjendjes së rënd financiare të qytetarëve. Kjo amulli është krijuar si pasojë e mungesës së rregullativës së duhur juridike për normimin e tregut financiar dhe të biznesit të lirë në Kosovë. Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese ka gjetur se ligji objekt kontrolli binte ndesh me Kushtetutën në disa aspekte, ndër më kryesorët ishin ato që kishin të bënin me prishjen e tregut të lirë dhe barazisë së palëve në treg. Ajo që ligjvënësi kosovar kishte dashur të bëj me këtë ligj për rregullimin e mikrofinancave konsistonte në lejimin e futjes në treg të miliona eurove të fituara nga agjensionet mikrofinanciare që asnjëherë nuk kishin paguar tatim, para këto që i kishin fituar nga taksapaguesit e huaj dhe vendorë në emër të ndihmës për Kosovën në ngritjen e kapaciteteve të saj në të gjitha fushat e jetës. Të njëjtin kapital tani dëshironin përmes ligjit ta ndajnë ndërmjet veti dhe ta fusnin në tregun e biznesit për përfitime krejtësisht personale, duke rrënuar kështu parimin e barazisë dhe tregun e lirë dhe lirinë e tregut.

Në këto dy raste si më sipër, pikë referimi dhe parametër kushtetues për vlerësimin e kushtetutshmërisë kanë shërbyer liritë dhe të drejtat e garantuara me Kushtetutë.[98] Është shumë domethënëse që në rastin **Rajfajsen** dhe në rastin e **Ligjit për Mikrofinancat**, si përfaqësues ligjor kanë shërbyer personat nga mesi i komunitetit të avokatëve që u bënë të pasur pas luftës me një shpejtësi marramendëse, duke luajtur kryesisht rolin e **sekserit** ndërmjet gjyqësorit dhe organeve të drejtësisë dhe palëve në procedurë. Autori i këtyre rreshtave ka pasur presion dhe ndërhyrje nga dy gjyqtarë kushtetues të kohës, një vendor dhe një ndërkombëtar, për të anuluar vendimin e **GJSK**, gjë që do të kishte qenë **konstitucionalizim i fajdes** dhe eksploatimit mizor të qytetarëve të Kosovës, me bekimin e gardianit të Kushtetutës. Ndërhyrje ka pasur edhe nga pjesëtarë të komunitetit të avokatëve të Kosovës, të cilët në marrëveshje me dy gjyqtarët e sipër cekur kishin ushtruar presion intensiv me muaj të tërë, derisa autori i parë i këtij libri kishte dhënë urdhër për vendosje dhe mbyllje të rastit **Rajfajsen** njëherë e mirë.

16.7. Rasti Asociacionit Serb

Marrëdhëniet Kosovë-Serbi, në kuptimin politik, përbëjnë nyjën e qetësisë në Ballkanin Perëndimor. Këto marrëdhënie janë pjesë e peizazhit të përgjithshëm ballkanik të marrëdhënieve serbo-shqiptare, marrëdhënie të cilat nuk kanë pasur një harmoni e qetësi për të shumtën e kohës. Këtu e kemi fjalën për kohën e fillimit të shekullit XIX e deri më sot, pra për kohën nga fillimi i formimit të shteteve nacionale në **Ballkan**, kur ballkanasit luftuan për emancipim e çlirim nga **Perandoria Osmane**. Ky seksion i këtij kapitulli, sigurisht, nuk ka për qëllim që të merret me çështjet e na-

[98] Në rastin e **Aktgjykimit të GJSK**, megjithatë, liritë dhe të drejtat e njeriut u keqpërdorën sepse mbrojtja e tyre u bë në bazë të parametrave të palejueshëm kushtetues. U përdorën në mënyrë arbitrare nene të instrumenteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare në mënyrë të drejtpërdrejtë, ani se ato kishin të bënin me detyrime ndërkombëtare të Kosovës, të marra njëanshëm mbi vete në bazë të nenit 22 i Kushtetutës. Ato detyrime nuk kanë natyrë të vetekzekutueshme, ashtu që vënia e tyre në jetë kërkon nxjerrjen e ligjeve dhe akteve të tjera normative, siç janë **LZP** dhe rregullativat e institucionet tjera brenda **KQZ**, me qëllim të trajtimit të ankesave dhe parashtresave të subjekteve politike dhe individëve që lidhen me rregullsinë ligjore të zgjedhjeve nacionale.

cionalizmit në **Ballkan**, e as me marrëdhëniet e popujve të **Ballkanit** nga këndvështrimi historik. Qëllim dhe synim i tij është të sqarojë aspektet juridiko-kushtetuese të disa marrëveshjeve të lidhura ndërmjet **Kosovës** dhe **Serbisë** në vazhdën e përpjekjeve të përgjithshme vendore dhe ndërkombëtare për stabilizimit të marrëdhënieve në mes të këtyre dy vendeve të trazuara të **Ballkanit.**

Aspektet juridiko-kushtetuese të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të cilat kanë dominuar skenën politike, publike e akademike pas shpalljes së pavarësisë së vendit më 17 shkurt 2008 dhe fillimit të dialogut me Serbinë në Bruksel në vitin 2013, me ndihmën dhe me ndërmjetësimin e **Bashkimit Evropian** (**BE**), nuk kanë qenë edhe aq dominante. Aspektet politike kanë qenë dhe mbeten primare në marrëdhëniet Kosovë-Serbi. Aspektet juridiko-kushtetuese kanë qenë kryesisht të lidhura për natyrën juridike të disa marrëveshjeve të lidhura ndërmjet dy vendeve dhe vendin e tyre në sistemin juridik nacional. Nuk ka rëndësi që dialogu me **Serbinë** nuk doli të jetë krejt teknik, siç thuhej dhe siç ishte më 2005, kur autori i këtyre rreshtave kishte udhëhequr një dialog Kosovë-Serbi me ndërmjetësimin e **BE**-së dhe të **SHBA**-së, kur asnjë marrëveshje nuk u arrit në **Vjenë** përveç marrëveshjes që të vazhdohet me dialog edhe në të ardhmen. Këto aspekte krejt socio-politike, që vetëm më vonë do të reflektohen në dimensionin e tyre juridik-kushtetues, do të trajtohen në nënseksionin e parë të këtij seksioni. Kjo sepse vetëm kështu mund të hapet rruga për të kuptuar nënseksionin e dytë në vijim, ku flitet për vendin dhe për fuqinë juridiko-kushtetuese të traktateve ndërkombëtare në sistemin e brendshëm kosovar.

Në diskursin kosovar, pas kontrollit kushtetues të **Marrëveshjes së Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë***,* të 19 prillit 2013, ratifikuar nga **Kuvendi i Kosovës** më 27 qershor 2013 me Ligjin nr. 04/L-199 (**Marrëveshja e Parë**), u pa qartë se ka një mosnjohje të skajshme të koncepteve bazike nga e drejta kushtetuese që lidhen me ratifikimin, me llojet dhe me funksionin e tij, me vendin dhe me fuqinë juridiko-kushtetuese të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në sistemin e brendshëm juridik-kushtetues kosovar, si dhe me statusin e marrëveshjeve ndërkombëtare të paratifikuara në kuadër të këtij sistemi, përfshirë këtu edhe mundësitë eventuale të kontrollit të tyre kushtetues. Kjo mosnjohje, në veçanti, shihet në mesin e komunitetit juridik, por edhe më gjerë në publikun e gjerë kosovar, gjë që u bë krejt e qartë pas nënshkrimit, më 25 gusht 2015 në Bruksel, të **Marrëveshjes mbi Parimet e Përgjithshme Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe** (**Marrëveshja e Dytë**). Kjo marrëveshje nuk iu nënshtrua asnjë ratifikimi, por që, lidhur me të, Gjykata Kushtetuese u prononcua në një mënyrë krejtësisht të çuditshme me **Aktgjykimin KO 130/15**, të 23 dhjetorit 2015, i cili do të elaborohet gjerësisht në vijim.

Këto dy çështje, pra çështja e vendit dhe e rolit të marrëveshjeve ndërkombëtare në sistemin juridik-kushtetues kosovar, si dhe kushtet e mënyrat për aplikim të kontrollit kushtetues ndaj tyre, do të jenë objekt i një trajtimi të veçantë në nënseksionet tre dhe katër të këtij seksioni, duke bërë të qartë se ka një dallim substancial ndërmjet paragrafit 1, të nenit 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës dhe paragrafit 2 të po këtij neni, diçka që ekziston pak a shumë thuajse në të gjitha kushtetutat e vendeve evropiane, si të ish-vendeve komuniste ashtu edhe të demokracive tradicionale të Kontinentit të vjetër. U mor vesh, formulimet e dispozitave dallojnë, por mesazhi ngel i njëjtë: ekzistojnë disa lloje të marrëveshjeve ndërkombëtare që i nënshtrohen ratifikimit të brendshëm nga ana e organit përfaqësues, por edhe disa të tjera që mund të ratifikohen edhe nga Shefi i Shtetit, nga Qeveria ose nga organi tjetër kushtetues i autorizuar për një gjë të tillë. Ratifikimi i këtyre të fundit quhet ratifikim ndërkombëtar, për dallim nga ratifikimi i brendshëm ose kushtetues që ka të bëjë me rastet kur akti i ratifikimit ndërmerret nga parlamenti. Dy llojet e ratifikimit do të diskutohen e do të trajtohen në këtë seksion në vijim.

16.7.1. Rrethanat e krijimit të rastit

Marrëdhëniet Kosovë-Serbi, siç e thamë më sipër, nuk janë objekt trajtimi i këtij punimi, në veçanti jo në aspektin e historisë së tyre dhe të problemeve që janë krijuar përgjatë shekujve.[99] Sa për lexuesin jo mjaft të informuar, megjithatë, besojmë që ka nevojë të thuhen disa fjalë shumë shpejt e shkurt lidhur me atë se si ka ardhur gjendja deri këtu, në mënyrë që të kuptohen aspektet juridiko-kushtetuese të këtyre marrëdhënieve që kanë qenë objekt vendimmarrjeje në **Gjykatën Kushtetuese**. Në fakt ajo që pason është trajtuar gjerësisht në kapitullin **10,** që bën fjalë për historinë e gjyqësisë kushtetuese kosovare deri në fitimin e pavarësisë. Këtu diskutojmë materien për të cilën kemi folur atje, por në një mënyrë më të ngjeshur dhe më dinamike.

Kosova, në periudhën prej mbarimit të **Luftës së Parë** e deri në mbarim të **Luftës së Ftohtë**, ka qenë pjesë e asaj që njihet si ish-Jugosllavi. Ndërmjet dy luftërave botërore, **Jugosllavia** ka qenë me rregullim shtetëror monarkik, për t'u kthyer në një republikë komuniste pas mbarimit të **Luftës së Dytë Botërore**. Si e tillë, pra si republikë komuniste, ish-Jugosllavia ka ekzistuar deri në mbarim të **Luftës së Ftohtë** kur edhe qe shpërbërë. Nga rrënojat e saj u krijuan fillimisht pesë shtete sovrane dhe të pavarura, e më vonë, më 17 shkurt 2008, nga mbetjet e asaj që u krijua më 1992, si **Republika Federale e Jugosllavisë** (**Serbi-Mali i Zi**), u krijuan shteti i Malit të Zi dhe shteti i Kosovës, si dy entitete sovrane e të pavarura. Trashëgimia i ish-Jugosllavisë dhe mbyllja e procesit të shpërbërjes në planin ndërkombëtar kishin ndodhur **de facto** më 1992, kurse **de jure** vetëm më 2001, kur u lidh **Marrëveshja mbi Trashëgiminë** ndërmjet pesë shteteve të dala nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë.[100] Me pavarësimin e **Malit të Zi**, më 3 qershor 2006, trashëgimia ndërmjet këtij shteti dhe Serbisë ka ndodhur me automatizëm sipas një marrëveshjeje të lidhur nga to në **Beograd**, më 2002, duke ia ndërruar emrin nga **Republika Federale e Jugosllavisë** në **Unioni Serbi-Mali Zi**. Sipas kësaj marrëveshjeje, largimi eventual i njërit prej anëtarëve nga Unioni nënkuptonte që secili duhet t'i zbatojë në mënyrë paqësore dhe me marrëveshje dispozitat e **Marrëveshjes mbi Trashëgimin** e ish-Jugosllavisë.

Kosova, pas 10 qershorit 1999, u fut nën administrim ndërkombëtar të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) sipas **Rezolutës 1244** të **Këshillit të Sigurimit** (KS). Administrata njihet me akronimin **UNMIK**. Kjo rezolutë, sikundër dihet, mandatonte KS-në që në Kosovë të instalonte një administratë ndërkombëtare me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve vendore për vetëqeverisje lokale, deri në zgjidhjen e statusit politik të Kosovës. Në aspektin formal, sipas kësaj rezolute, **Kosova** ende trajtohej si pjesë formale e **Republikës Federale të Jugosllavisë** (**Serbi-Mali i Zi**), përkatësisht e **Unionit Serbi-Mali Zi,** ku sovraniteti i këtij shteti mbi **Kosovën** konsiderohej i suspenduar **ipso facto**. Më 17 shkurt 2008, Kosova shpalli pavarësinë pas një sërë negociatash të ndërmjetësuara nga ish-presidenti finlandez **Martti Ahtisaari**, i cili hartoi një projekt ndërkombëtar mbi bazën e të cilit **Kosova** shpalli pavarësinë më 17 shkurt 2008.[101] Ky projekt, i njohur si **Plani Ahtisari**, nuk u pranua nga pala serbe e as nga KS i OKB-së, i cili edhe kishte mandatuar

---

[99] Për këtë çështje, shih më shumë te libri i jashtëzakonshëm i Noel Malcolm-it, *Kosovo. A Short History* (New York University Press: New York, 1999). Në fakt, analiza jo vetëm historike, por edhe juridike-ndërkombëtare e statusit të Kosovës brenda ish-Jugosllavisë ngërthen një mprehtësi të veçantë të autorit që meriton edhe vëmendje të veçantë. Kjo bëhet në kapitullin e fundit që flet për Kosovën pas vdekjes së **Titos**, deri më 28 prill 1999, kur është dorëzuar për botim dorëshkrimi i librit.

[100] Marrëveshja është lidhur në Vjenë, më 29 qershor 2001, ndërmjet Bosnjë e Hercegovinës, Kroacisë, Republikës Federale të Jugosllavisë (Serbi-Mali i Zi), Sllovenisë dhe Maqedonisë. Për trajtim akademik të kësaj marrëveshjeje, Cf. më shumë në Enver Hasani, *The Evolution of Succession Process in Former Yugoslavia*, botuar në *Tomas Jefferson Law Review,* Vol. 29, No. 1 2006; ribotuar me leje te autorit edhe në *Miskolc Journal of International Law* Vol. 4 No. 2, 2007 (Hungari). Për versionin e përditësuar të këtij punimi në gjuhën shqipe, Cf. Enver Hasani, "Specifikat e trashëgimit të ish-Jugosllavisë dhe pozita e Kosovës në të" botuar në *E drejta/Law* nr. 1/2012 (revistë për çështje juridike dhe shoqërore), Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Prishtinë.

[101] Në prill të vitit 2007, Emisari Special i OKB-së, **Martti Ahtisaari**, ka parashtruar në KS të OKB-së **Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës** (**Plani Ahtisaari**). Plani Ahtisari ka një tekst kryesor me 15 nene të cilat përcaktojnë parimet e përgjithshme, si dhe 12 ankese që elaborojnë këto parime. Plani Ahtisaari ka të bëjë në rend të parë me mbrojtjen e të drejtave, të identitetit dhe të kulturës së komuniteteve joshqiptare të Kosovës, duke përfshirë këtu themelimin e një kuadri për pjesëmarrjen e tyre në jetën publike. Emisari Special **Martti Ahtisaari** propozoi që Kosova të bëhej e pavarur me kusht që të ketë një periudhë të mbikëqyrjes së kësaj pavarësie të Kosovës. Titulli i plotë i **Planit Ahtisaari** është **Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës**, 2 shkurt 2007. Në internet: https://reliefweb.int/report/serbia/comprehensive-proposal-kosovo-status-settlement-s2007168 add1 (shikuar në shkurt 2019).

misionin e presidentit **Martti Ahtisaari** me qëllim të zgjidhjes së statusit përfundimtar të Kosovës. Më 22 korrik 2010, **GJND** deklaroi se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk mund të kontestohej dhe se nuk bie ndesh me asnjë pjesë të së drejtës pozitive ndërkombëtare.[102] Të gjitha këto gjëra janë sqaruar dhe janë vënë në dukje në kapitujt pararendës.

Sado që **Plani Ahtisari** kishte parashikuar një mekanizëm shumë të detajuar dhe unik për kushtet kosovare për mbrojtjen e komuniteteve jo shumicë, çështja e mbrojtjes dhe e promovimit të komuniteteve jo shumicë në Kosovë, me kuptim këtu në rend të parë komunitetin serb, ngeli një problem akut. As ajo që u cilësua si decentralizim, i nisur para vitit 2008 por që më pastaj u vazhdua, nuk ka dhënë një përgjigje të kënaqshme në këtë aspekt, ashtu që sërish u hap një dialog teknik që filloi gjatë vitit 2011 e që ende zgjat deri në kohën e shkrimit të këtij punimi. Në kuadër të këtij dialogu teknik kanë lindur disa marrëveshje, prej të cilave, për qëllimet e këtij punimi, më të rëndësishme janë dy: **Marrëveshja e Parë** dhe **Marrëveshja e Dytë**. Ky dialog nga viti 2018 ka marr formën dhe tiparet e një dialogu tipik politik që mëton zgjidhjen njëherë e përgjithmonë të marrëdhënieve Kosovë-Serbi në të gjitha aspektet e tyre.

Marrëveshja e Parë ka gjithsej 15 paragrafë, prej të cilëve paragrafët 1 deri në 6 flasin gjerësisht dhe në mënyrë konkrete për themelimin e një asociacioni të komunave me shumicë serbe. Ky asociacion, sipas tekstit të Marrëveshjes, themelohet nëpërmjet **Statutit** dhe modelohet mbi bazën e strukturës e formës së asociacionit ekzistues të komunave të **Kosovës**.

Marrëveshja e Dytë ka gjithsej 22 paragrafë dhe në tërësi shtjellon dispozitat e **Marrëveshjes së Parë**, por duke e cilësuar tani si një asociacion që mbron e që promovon interesat e serbëve lokalë, që ka një status juridiko-administrativ **on par** me personat juridikë nga e drejta publike në **Kosovë** me të gjitha pasojat që bart një status i tillë juridiko-kushtetues, që Qeverisë i jep tagrin e dekretimit të **Statutit të Asociacionit**, kurse **Gjykatës Kushtetuese** një "juridiksion shtesë" sa i përket kontrollit të kushtetutshmërisë së këtij statuti pasi të jetë draftuar nga komisioni menaxhues dhe pas vërtetimit me dekret qeveritar. Në shikim të parë, duket qartë se **Marrëveshja e Dytë** dukshëm del nga kuadri i përcaktuar i **Marrëveshjes së Parë** sepse krijon statuse, të drejta dhe detyrime të nivelit lokal, që mund të cenojnë rëndë parimet themelore të sistemit kushtetues kosovar. Për këtë kemi folur gjerësisht ende para prononcimit të **Gjykatës Kushtetuese** me verdiktin e vet të sipërcekur në rastin **KO 130/95**, të 23 dhjetorit 2015.[103]

Opozita kosovare, që nga momenti i bërjes publike në gusht të vitit 2015 të tekstit të **Marrëveshjes së Dytë**, ka filluar kundërshtimin e saj, përfshirë këtu edhe metodat jopolitike e violente. Fjalët çelës të opozitës kanë qenë nga fillimi se fare nuk duhet të ndodhë themelimi i **Asociacionit të Komunave Serbe**, ndërkohë që Qeveria deri në fund ka qenë e bindur se kjo duhet të ndodhë dhe se, në këtë drejtim, nuk ka pasur asnjë tejkalim të kompetencave të saj me rastin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Dytë, më 25 gusht 2015. Situata jashtëzakonisht e tensionuar politike bëri që znj. **Atifete Jahjaga**, presidente e Kosovës, çështjen ta dërgojë në **Gjykatën Kushtetuese**, në vijim të vënies në jetë të kompetencave të saj kushtetuese si përfaqësues i unitetit juridik-kushtetues të popullit të Kosovës.[104] Kërkesa u dërgua më 31 tetor 2015 dhe me të kërkohej që Gjykata të përgjigjej në pyetjen si vijon:

---

[102] Mendimi Këshillëdhënës është kërkuar nga **Asambleja e Përgjithshme** e **OKB**-së me insistimin e Qeverisë së Serbisë. **GJND**-ja, me këtë mendim këshillëdhënës, ka bërë të qartë në mënyrë elokuente se deklarimi i pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 ka ndodhur si rezultat i ushtrimit të **pouvoirs constituant** përmes përfaqësuesve të vet krejtësisht jashtë rendit juridik të krijuar nga **UNMIK**-u. Sipas **GJND**-së, kjo nënkuptonte se rendi i ri juridiko-kushtetues, i krijuar në **Kosovë** pas shpalljes së pavarësisë, është një rend tërësisht i ri dhe i ndryshëm nga rendi pararendës. Për më tepër, ky rend as që mëtonte të ishte vijimësi e rendit paraprak që ka ekzistuar në **Kosovë** në çdo kohë deri më 17 shkurt 2008 kur u shpall pavarësia e Kosovës. Më shumë për këtë shih paragrafët 52-56; 74-84; 96-109 dhe 114-121, të **Mendimit Këshillëdhënës** të **GJND**-së të 22 korrikut 2010 lidhur me atë nëse deklarata e njëanshme e shpalljes së pavarësisë së Kosovës ishte në pajtim me të drejtën ndërkombëtare.

[103] Shkrimi i parë publik që konstaton disa cenime të rënda kushtetuese të tekstit të Marrëveshjes së Dytë i ka bërë autori i këtyre rreshtave në një shkrim të gjatë të titulluar: *Marrëveshja ia njeh pushtetin kushtetutbërës Asociacionit*, botuar në të përditshmen kosovare **ZËRI DITOR**, më 4 nëntor 2015 (fq. 10-11). Në këtë punim pak a shumë trajtohen gjërat e njëjta me ato të botuara në gazetën e sipërcituar **ZËRI DITOR**.

[104] Neni 83 [Statusi i Presidentit] i Kushtetutës: "Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikë së Kosovës".

"Duke marrë parasysh se Parimet e Asociacionit rregullojnë krijimin dhe funksionimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë, a janë në përputhshmëri këto parime dhe elemente me frymën e Kushtetutës, neni 3, paragrafi 1 (natyra shumetnike), me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës?".

Nga kërkesa qartë shihet se Presidentja nuk ka konsideruar që Kosova ka ndonjë detyrim ndërkombëtar për Kosovën nga nënshkrimi i **Marrëveshjes së Dytë** në vitin 2015. Për më tepër, fare nuk konsiderohet se **Marrëveshja e Dytë** ka formën apo përmbajtjen e një detyrimi valid ndërkombëtar të shtetit të Kosovës. Kjo sjellje kështu ka kushtëzuar edhe sjelljen dhe përgjigjen e Gjykatës dhe buron si pasojë e situatës jashtëzakonisht të nderë që ka mbretëruar në Kosovë që nga vjeshta e vitit 2014. Kjo u vë në dukje këtu vetëm sa për të treguar arsyet e një kërkese të tillë të bërë në panik, si dhe të një verdikti të Gjykatës të dhënë po ashtu në panik. Kjo në asnjë mënyrë nuk amniston padijen profesionale respektive të aktorëve si më sipër, të cilët në çdo situatë e nën çdo presion duhet ta mbrojnë **Kushtetutën e Kosovës**, pjesën e dispozitave që janë esenciale për të ruajtur reputacionin e **Kosovës** ndërkombëtarisht, të atyre dispozitave që flasin për statusin juridiko-kushtetues të detyrimeve ndërkombëtare të marra nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare. Parimi i proporcionalitetit me rastin e gjykimit dhe zgjidhjes së çështjeve që kanë implikime ndërkombëtare vjen i pari në këtë aspekt.[105] Kjo nënkupton se nuk ka logjikë dhe nuk shkon që **Gjykata Kushtetuese** të luajë rolin e një gjykate ndërkombëtare dhe të amnistojë gabimet e padijen e politikës kosovare, të bëra në planin ndërkombëtar nëpërmjet shtjellimeve juridiko-kushtetuese që nuk kanë mbështetje në asnjë teori ose praktikë kushtetuese komparative. Ta shohim më nga afër këtë problematikë.

16.7.2. Vendi i marrëveshjeve ndërkombëtare në rendin e brendshëm

Në **Evropë**, për momentin, ekzistojnë tri lloje të sistemeve juridiko-kushtetuese që përcaktojnë vendin dhe rolin e traktateve ndërkombëtare në sistemin e brendshëm.[106] Në disa shtete, kushtetutat nacionale u japin një status special, në veçanti kur flitet për traktatet nga fusha e të drejtave të njeriut;[107] në disa të tjera, traktatet kanë statusin ndërmjet kushtetutës dhe ligjit;[108] dhe, së fundi, në disa vende evropiane, traktatet e të gjitha llojeve, me kushtetutë nacionale, gëzojnë statusin e ligjit të

[105] Siç e ka thënë **Hans Kelsen (Hans Kelsen: 1881-1973)** shumë kohë më herët, më 1929, nuk ekzistojnë pengesa juridike që të parashikohet kontrolli kushtetues represiv i marrëveshjeve ndërkombëtare. As në të drejtën kushtetuese nuk ka një pengesë të tillë. Por, sipas tij, ka pengesa të natyrës politike që shteti duhet mirë t'i peshojë kur vendos për një hap të tillë, gjithnjë me supozim që në tekstin kushtetues ekziston një dispozitë e tillë shprehimore që lejon kontrollin kushtetues represiv të marrëveshjeve ndërkombëtare. Cf. më shumë për **Hans Kelsen**, si dhe për zbatimin e parimit të proporcionalitetit dhe shtjellimet tjera të tij në mes të dy luftërave botërore, në disertacionin e pabotuar të doktoratës të Olivera Vucic, *Austrijsko ustavno sudstvo – čuvar federacije i ustava* (mbrojtur më 1995 në Fakultetin Juridik të Universitetit të Beogradit), fq. 200-204.

[106] Mbi statusin e marrëveshjeve ndërkombëtare në të drejtën e brendshme në përgjithësi në aspektin komparativ, Cf. më shumë Anne Peters, "Supremacy Lost: International Law Meets Domestic Constitutional Law". *Vienna Journal on International Constitutional Law*. Vol 3 Issue 3 (September 2009) fq. 170-198.

[107] Kjo është kështu me shumicën e shteteve të ish-lindjes komuniste ku traktatet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut kanë status të privilegjuar në sistemin e tyre juridiko-kushtetues, duke qëndruar mbi ligjet e zakonshme, në disa raste edhe baras me vetë kushtetutat nacionale (p.sh., **Shqipëria** dhe **Maqedonia**). Ky trend i ndërkombëtarizimit ka filluar pas mbarimit të **Luftës së Ftohtë**. Cf. më shumë në materialet si vijon: Eric Stein, "International Law in Internal Law: Towards Internationalisation of Central – Estern European Constitutions". *American Journal of International Law* Vol. 88 No. 3 (July 1994) fq..427-450; European Commission for Democracy Through Law (Vennice Commission), "The Relationship Beteween International and Domestic Law". *Science and Technique of Democracy* No.5. CDL- STD (1995) 005 (**Strasburg**, 15 September 1993), në veçanti seksioni: *The Implementation of International Human Rights Agreements*.

[108] Ky është standardi i pranuar nga shumica e vendeve evropiane, pa llogaritur këtu traktatet mbi të drejtat e njeriut. Kjo do të thotë se, në shumicën e vendeve evropiane, traktatet ndërkombëtare të ratifikuara nga parlamenti bëhen pjesë e sistemit të brendshëm pas publikimit të tyre në një gazetë zyrtare dhe mund të zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke pasur kështu fuqinë mbi ligjin e zakonshëm që rri sipas fuqisë juridike menjëherë pas dispozitave kushtetuese. Cf. Thomas Burgenthal, "Modern Constitutions and Human Rights Treaties". *Columbia Journal of Transnational Law* Vol. 36 (Special Double Issue) 1997, fq. 211-223; European Commission for Democracy Through Law (Vennice Commission), "The Relationship Beteëeen International and Domestic Law", në veçanti seksioni: *The Elaboration of Model Clauses on the Relationship Between International and Domestic Law*.

zakonshëm.[109] Këtu bën përjashtim **Holanda**, e cila i jep një primat absolut të drejtës ndërkombëtare, pa marrë parasysh burimin e saj (traktat, zakon ndërkombëtar apo burim tjetër i të drejtës ndërkombëtare).

Kosova bën pjesë në kategorinë e shumicës së shteteve evropiane që traktatit ndërkombëtar ia njohin fuqinë mbi ligjin e zakonshëm dhe nën dispozitat kushtetuese, me përjashtim të traktateve mbi të drejta e njeriut të cilat kanë fuqinë e normës kushtetuese si çdo normë tjetër kushtetuese.[110] Kjo zgjidhje e fundit ekziston edhe në rastin e **Bosnjës e Hercegovinës**, ani se atje detyrimi kushtetues është pjesë përbërëse e **Marrëveshjes së Dejtonit** (1995), si marrëveshje ndërkombëtare e regjistruar në Sekretariatin e **OKB**-së.

Kushtetuta e ka përcaktuar qartë një standard të marrëdhënies në mes të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe ligjeve kosovare, duke ua njohur të parave statusin më të ulët se Kushtetuta e më të lartë se ligji i zakonshëm. Ky standard i vënë kësisoj nënkupton që çdo normë, e cila bie ndesh më një normë ndërkombëtare kontraktuale, shfuqizohet në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj të fundit.[111] Tani këtu shtrohet pyetja nëse një status të tillë juridiko-kushtetues e kanë vetëm marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga **Kuvendi i Kosovës** (ratifikimi i brendshëm),[112] në kuptim të nenit 18.1

---

[109] Në **Britaninë e Madhe** dhe në vendet e tjera të modeluara sipas saj, nuk bëhet ndonjë dallim ndërmjet traktateve ndërkombëtare të përgjithshme dhe atyre mbi të drejtat e njeriut, sepse dy llojet e traktateve në fjalë kanë statusin e ligjit të zakonshëm britanik. Cf. më shumë te Anthony Aust, *Modern Treaty Law in Practice* (Cambridge University Press: Cambridge, 2000) fq. 151-154.

[110] Kjo shihet shumë qartë nga vetë formulimi i nenit 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës. Ky nen përcakton, **inter alia**, se të drejtat dhe liritë e njeriut, të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare të cilat përmenden në këtë nen, garantohen me Kushtetutë dhe zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës. Në rast konflikti, thuhet më tej në këtë nen, ndërmjet dispozitave të ligjeve dhe të akteve të tjera të institucioneve publike kosovare dhe këtyre dokumenteve ndërkombëtare, atëherë përparësi kanë këto të fundit.
Dokumentet ndërkombëtare, të cilat përmenden në nenin 22 të Kushtetutës si më sipër, janë si vijon: (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës; dhe (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.
Sikundër shihet, nga kjo listë përjashtohen marrëveshjet apo dokumentet ndërkombëtare që garantojnë të drejtat socio-ekonomike. Kjo për faktin se në një vend si **Kosova**, një listim i tillë do të shkaktonte pritje joreale dhe keqkuptime, të cilat do të mund të shërbenin si bazë për revolucione e përmbysje të tjera sociale në çdo kohë.
Në fund të kësaj, vlen të theksohet se, sipas nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, e tërë praktika gjyqësore dhe çdo praktikë tjetër e organeve publike në **Kosovë** duhet të mbështetet në interpretimet e **GJEDNJ**-së. Këtë, shprehimisht, e vë në dukje dispozita e nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, e cila thotë: "Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".

[111] Neni 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare] i Kushtetutës: "1. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi të botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe kur zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji; 2. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës".

[112] Fjala "ratifikim" ka rrënjë latine dhe ka kuptimin e pëlqimit, të vërtetimit. Si e tillë, ajo përbëhet nga dy pjesë: e para**, ratus**, që domethënë i vlefshëm dhe, e dyta, **facere**, që domethënë për të bërë.
Ekzistojnë dy lloje të ratifikimit: **ratifikimi i brendshëm** dhe **ratifikimi ndërkombëtar**. Ratifikimi ndërkombëtar është një dokument formal-juridik më të cilin shteti jep pëlqimin në planin ndërkombëtar për t'u konsideruar i lidhur për një marrëveshje ndërkombëtare. Ratifikimi i brendshëm bëhet në shumicën e rasteve nga organi përfaqësues. Në kohët e vjetra, ratifikimin e brendshëm e ka bërë mbreti dhe ka pasur efekt retroaktiv ngaqë me aktin e tillë mbreti ka vërtetuar **post festum** veprimet e përfaqësuesit të tij. Më vonë, kjo prerogativë iu njoh parlamentit dhe që atëherë ka shërbyer si një mjet kontrolli ndaj veprimeve të ekzekutivit. Kjo ka qenë pjesë e luftës për parlamentarizëm.
Ndërkohë që ratifikimi i brendshëm është kategori që rregullohet më kushtetutë, ratifikimi ndërkombëtar normohet me nenin 14 ["Pëlqimi për t'u detyruar me traktat i shprehur me ratifikim, pranim ose miratim"] lidhur me nenin 2 ["Përdorimi shprehjeve"] të **Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve (KVDT)**. Për tesktin e KVDT, cf. Vienna Convention on the Law of Treaties 1969. Në internet: https://legal.un.org/ilc/texts/instruments /english/conventions/111969.pdf. Për komentet rreth ratifikimit në kuptimin si më sipër, cf. më tepër në, Frank Hoffmeister, *Consent to be bound by a treaty expressed by ratification, acceptance or approval;* te Dörr, Oliver, Schmalenbach, Kirsten (eds.), *Vienna Convention on the Law of Treaties. A Commentary* (SPRINGER: Verlag Berlin Heidelberg, 2012) fq. 182-183; Boris Krivokapić, *Enciklopedijski rečnik medjunarodnog prava i medjunarodnih odnosa* (JP Službeni Glasnik: Beograd, 2010) str. 903-904; Ian Brownlie, *Principles of Public International Law,* Sixth Edition (Oxford University Press: Oxford, 2003) fq. 582-583; Vladimir Ibler, *Rječnik Medjunarodnog Javnog Parava* (Informator: Zagreb, 1972) fq. 55, 253 & 313.

të Kushtetutës,[113] apo çdo marrëveshje tjetër ndërkombëtare, pa marrë parasysh llojin e ratifikimit, siç përcaktohet në nenin 18.2 të Kushtetutës? Formulimi i këtij neni, në veçanti paragrafi i dytë i tij, nuk dallon në esencë, për nga mesazhi që bart, nga kushtetutat e vendeve të tjera evropiane.[114] Kjo për arsye se ekzistojnë marrëveshje ndërkombëtare që lidhen në mënyrë të vlefshme sipas dispozitave të **KVDT**, përkatësisht sipas standardeve të së drejtës zakonore ndërkombëtare, por të cilat nuk i nënshtrohen ratifikimit të brendshëm. I tillë është rasti me **Marrëveshjen e Dytë**, e cila në pikëpamje të së drejtës ndërkombëtare zakonore ka statusin e marrëveshjes së lidhur në vazhdim të zbatimit të qëllimeve dhe të objektit të **Marrëveshjes së Parë**. Nga aspekti i të drejtës së brendshme, **Marrëveshja e Dytë** ka karakter të **normëvënies implementuese**[115] që administron mënyrën e zbatimit dhe detajet e tjera që lidhen me vënien në jetë të **Marrëveshjes së Parë**. Lidhja e **Marrëveshjes së Dytë** në **Bruksel**, më 25 gusht 2015, sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare është e barabartë me ratifikimin ndërkombëtar. Arsyet për këtë konkludim jepen në rreshtat në vijim. Të shohim si duket kjo.

Sqarimi i natyrës juridiko-ndërkombëtare dhe juridiko-kushtetuese të **Marrëveshjes së Dytë** ka rëndësi për dy arsye: e para, sepse ekziston një parim zakonor ndërkombëtar i cili quhet parimi **bona fide**, i cili nënkupton se **pacta sunt servanda** duhet të zbatohet me mirëbesim, pa marrë parasysh kufizimet e brendshme juridiko-kushtetuese të shteteve; dhe, e dyta, në rastet kur një marrëveshje ndërkombëtare ka kaluar ratifikimin e brendshëm nga parlamenti, kontrolli kushtetues i normave të saj paraqet një problem serioz sepse kushtetutat zakonisht përcaktojnë disa kufizime mjaft të qarta të kufijve të kontrollit kushtetues, kufizime të cilat duhet t'i respektojnë gjykatat nacionale kushtetuese.[116]

Dilema, përkitazi me fuqinë e traktateve ndërkombëtare të lidhura në mënyrë të duhur nga ana e autoriteteve kushtetuese vendore, kanë pasur edhe vendet e tjera ish-komuniste të **Evropës**. Kjo për arsye se lidhja e një traktati mund të ndodhë që koincidon me aktin e ratifikimit ndërkombëtar. Kjo këtu nuk ka ndonjë rëndësi sepse, fundja, çdo detyrim i marrë ndërkombëtar duhet të zbatohet me mirëbesim, **bona fide**, nëse shteti i caktuar mendon të jetë një anëtar serioz i bashkësisë ndërkombëtare. **Kosova** nuk bën përjashtim në këtë drejtim, gjë e cila u pa gjatë dialogut me **Serbinë** pas lidhjes së disa marrëveshjeve ndërkombëtare, nga të cilat vetëm njëra iu nënshtrua ratifikimit nga **Kuvendi i Kosovës**, tanimë e cilësuar si **Marrëveshja e Parë**. Dilema kryesore që lindi ndër kosovarët ka pasur të bëjë me përcaktimin e statusit juridiko-kushtetues të marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare të cilat patën vetëm ratifikim ndërkombëtar të kryer nga njëri prej organeve kushtetuese kosovare që nuk ka nevojë për të pasur plotfuqi për ta futur shtetin në detyrim ndërkombëtar (Presidenti i Republikës, Kryeministri dhe ministri i Jashtëm).[117] Këto marrëveshje nuk kanë pasur ratifikim të brendshëm nga

---

113 Neni 18.1 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] i Kushtetutës:
"1. Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e dy të tretave (2/3) e të gjithë deputetëve ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare për këto çështje:
1) territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake;
(2) të drejtat dhe liritë themelore;
(3) anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare; dhe
(4) marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës".

114 Neni 18. 2 & 3 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] i Kushtetutës:
"2. Marrëveshjet ndërkombëtare, me përjashtim të atyre në pikën 1, ratifikohen pas nënshkrimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës.
3. Presidenti i Republikës së Kosovës ose Kryeministri njoftojnë Kuvendin sa herë që të nënshkruhet një marrëveshje ndërkombëtare".

115 Me këtë term nënkuptohet çdo normavënie dhe mund të ketë formën e ligjit, rregullores apo aktit tjetër të përgjithshëm, të aktit juridik individual dhe kështu me radhë.

116 Mbi kufijtë e kontrollit kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare, shih punimin e Maja Nastić, "Constituional Review of International Agreemnts: Comparative Law Perspective", botuar në *FACTA UNIVERSITATIS. Series: Law and Politics* (Nis, Serbia) Vol. 13, No 1, 2015, fq. 59 – 72; Për vendet e demokracive perëndimore tradicionale dhe ish lindjen komuniste e më gjerë, shih studimin e detajuar Dinah Shelton (ed.), *International Law and Domestic Legal Systems. Incroporation, Transformation, and Persuasion* (Oxford University Press: Oxford, 2011).

117 Sipas Kushtetutës së Kosovës, por edhe sipas kushtetutave të tjera dhe standardit zakonor ndërkombëtar, ratifikimi në fjalë mund të kryhet nga ana e shefit të Shtetit, shefit të Qeverisë dhe shefit të dikasterit të jashtëm (ministrit të Jashtëm). Këto tri organe nuk kanë nevojë për plotfuqi për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare. Cf. Neni 7.2 ("a") [Plotfuqitë] i **KVDT**.

Kuvendi i Kosovës dhe janë lidhur në vijim të implementimit të **Marrëveshjes së Parë**, të ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës, dhe kanë statusin e aktit apo normëvënies implementuese.[118] Me ratifikim ndërkombëtar, siç u theksua më herët, nënkuptohet ai veprim që rregullohet me dispozitat e **KVDT**-së dhe me të drejtën ndërkombëtare zakonore.

16.7.3. Kontrolli kushtetues i marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga parlamenti

Nisur nga kjo qasje lidhur me vendin dhe me rolin e marrëveshjeve ndërkombëtare në sistemin juridik u krijuan edhe juridiksionet përkatëse nacionale për kontrollin e tyre kushtetues. Në shumicën e vendeve ish-komuniste, marrëveshjet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me çështjet e ndjeshme të sovranitetit shtetëror, të financave shtetërore, të të drejtave të njeriut, të territorit etj., kërkohet t'i nënshtrohen ratifikimit parlamentar dhe pëlqimit të ekzekutivit, veprime që kryhen përmes nxjerrjes së një ligji të veçantë.[119] Një ligj me të cilin ratifikohet një marrëveshje ndërkombëtare, sipas zgjidhjeve kushtetuese të shumicës dërrmuese të vendeve ish-komuniste të **Evropës** por edhe më gjerë, nuk ka asnjë fuqi normative. Kjo do të thotë se ai ligj vetëm sa e fut në sistemin e brendshëm juridik-kushtetues një marrëveshje të lidhur ndërkombëtare, e cila, nëse ka norma të vetekzekutueshme,[120] mund të zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Kjo do të thotë se, në një rast të tillë, marrëveshja ndërkombëtare mund krijojë të drejta e detyrime për palët të cilat mund të realizohen pranë gjykatave e organeve të tjera nacionale në mënyrë të njëjtë si çdo ligj apo normë tjetër e brendshme.

Kjo është kështu edhe në **Kosovë,** gjë që bëhet e qartë me dispozitat e nenit 18.1 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës të cituar më lart. E njëjta vlen edhe për paragrafin e dytë në vijim të nenit të njëjtë, i cili flet për llojet e tjera të marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat nuk kërkojnë ratifikim të organit përfaqësues, por vetëm lidhjen e tyre me veprimin adekuat të organeve kushtetuese të cilat, sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare, nuk kanë nevojë të kenë plotfuqi: Shefi i Shtetit, Kryeministri, dhe, së fundi, ministri i Jashtëm. Për marrëveshjet e lidhura në këtë mënyrë vetëm njoftohet organi përfaqësues,

---

[118] Këtu nuk bëhet fjalë vetëm për **Marrëveshjen e Dytë**. Ka edhe marrëveshje në lëmenjtë e tjerë, të cilat janë lidhur në vazhdim të implementimit të **Marrëveshjes së Parë**. E tillë është, ta zëmë, **Marrëveshja për Telekomunikacionin në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë**, aprovuar me Vendimin e Qeverisë nr. 03/148. Vetëm **Marrëveshja e Dytë** ka qenë deri më sot objekt vendimmarrjeje në Gjykatën Kushtetuese, me Aktgjykimin KO130/15, të 23 dhjetorit 2015.
Marrëveshja për Telekomunikacionin nuk ka nevojë për ratifikim parlamentar meqë shërben si një akt juridik implementues i Marrëveshjes së Parë, e cila nga ana tjetër është ratifikuar me ligj të veçantë, me Ligjin nr. 04/L-199 të cekur më sipër. Si e tillë, Marrëveshja për Telekomunikacionin ka karakter implementues administrativ, siç kanë edhe Plani i Veprimit dhe të gjitha aktet e tjera të Qeverisë së Kosovës, të nxjerra në vijim të implementimit të detyrimeve ndërkombëtare të Kosovës të marra në bazë të Marrëveshjes së parë, të Kushtetutës dhe të ligjeve të Kosovës.

[119] Në fakt, edhe demokracitë e vjetra evropiane, si: Franca, Italia, Gjermania etj., kanë dispozita shprehimore kushtetuese që përcaktojnë saktë se marrëveshjet e caktuara të rëndësisë së veçantë shtetërore që prekin çështjet e sovranitetit territorial dhe shtetëror, financat, buxhetin apo ndonjë interes tjetër vital, ratifikohen me ligj nga ana e parlamentit nacional. Professor C. Economides, "The Relationship Between International and Domestic Law"*, Science and Technique of Democracy*, No. 6, CDL – STD 006 (Vennice Commission: **Strasbourg**, 1993).
Në vendet e sistemit anglosakson, në **Britani të Madhe** ta zëmë, nxjerra e ligjit, i cili quhet **enabling act** (ligji autorizues), kërkohet jo për të futur në sistemin e brendshëm një normë të një marrëveshjeje ndërkombëtare por për të transformuar tërësisht një normë të tillë ndërkombëtare duke e kthyer atë në një normë të brendshme juridiko-kushtetuese. Ky ligj nxirret zakonisht kur një marrëveshje ndërkombëtare, pra një normë e përmbajtur në një marrëveshje ndërkombëtare, afekton të drejtat dhe përgjegjësitë private, rezulton në ngarkesën e fondeve publike, ose kërkon ndryshimin e një ligji vendor ose të drejtës së përgjithshme (*common law*) me qëllim që ajo marrëveshje të mund të zbatohet nga ana e gjykatave të vendit. Cf. Franck C. Newman and David Wiessbrodt, *International Human Rights: Law, Policy, and Process* (Anderson Publishing Company: Cincinati, Ohio, 1996), fq. 23; Thomas Buergenthal, *Modern Constitutions and Human Rights Treaties,* 36 Columbia Journal of Transnational Law Vol. 36 Issue 1 (1997) fq. 213-216; Anthony Aust, *Modern Treaty Law and Practice,* Kapitulli 10 (*Treaties and Domestic Law*), fq. 143-161; Ian Brownlie, *Principles of Public International Law* (Oxford University Press: Oxford, 2003), fq. 44-45; David Weissbrodt and Connie de la Vega, *International Human Rights. An Introduction* (University of Pennsylvania Press: Philadelphia, 2007), fq. 4-6.

[120] Shih më shumë për këtë në punimin e shkëlqyer të David Sloss "Non-Self-Executing Treaties: Exposing a Constitutional Fallacy". *U.C. Davis Law Review*. Vol. 36 No. 1 (November 2002) fq. 2-84.

Kuvendi i Kosovës, për hir të zbatimit të parimit të transparencës së punës së organeve kushtetuese që janë të ngarkuara më punët e politikës së jashtme.

Sa i përket forcës juridiko-kushtetuese, ndërkaq, asnjë dallim nuk ekziston ndërmjet kategorisë së parë dhe të dytë, gjithnjë me kusht që janë publikuar në **Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.** Fuqia e tyre në praktikë varet nga natyra e normave që përmbajnë. Në rastet kur marrëveshjet e tilla kanë norma të vetekzekutueshme, zbatimi i tyre i drejtpërdrejtë nuk vihet në pikëpyetje. Në rastet kur ato nuk kanë një natyrë të tillë të vetekzekutueshme, atëherë kërkohet lidhja e një marrëveshje tjetër ndërkombëtare shtesë, apo nxjerrja e një akti tjetër shtesë vendor, të njohur si **normavënie implementuese**, të cilët kanë për qëllim implementimin e marrëveshjes së ratifikuar ndërkombëtare në kuptim të paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës.[121] Zaten, vetë emërtimi i këtij neni të Kushtetutës e bën të qartë, pa asnjë ekuivok, se bëhet fjalë për dy llojet e ratifikimit që u përfolën më lart.

Marrëveshjet nga nenit 18.1 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] i Kushtetutës nuk i nënshtrohen kontrollit kushtetues nga ana e **Gjykatës Kushtetuese**, si pasojë e faktit se standardi i kontrollit kushtetues të marrëveshjeve të tilla është shumë i rreptë dhe nuk lejon gjykatat kushtetuese të ndërhyjnë në komunikimin ndërkombëtar të shteteve, të cilat, nëse do ta kishin një të drejtë të tillë, atëherë do ta luanin rolin e një gjykate ndërkombëtare kushtetuese. Këtë pozitë e ka mbrojtur edhe **Gjykata Kushtetuese** në aktgjykimin e saj lidhur me kontrollin kushtetues të **Marrëveshjes së Parë**.[122] Me këtë aktgjykim, Gjykata ka bërë të qartë se, në vendet ku lejohet kontrolli kushtetues i marrëveshjeve ndërkombëtare, një gjë e tillë mund të bëhet vetëm para se ato të jenë ratifikuar nga ana e organit përfaqësues (ratifikimi i brendshëm). Pas ratifikimit, një gjë e tillë nuk mund të ndodhë sepse, siç ka konstatuar me të drejtë **Gjykata Kushtetuese,** një gjë e tillë do të pengonte seriozisht komunikimin ndërkombëtar ndërmjet shteteve. Në **Evropë** ekzistojnë shtete, të përmendura edhe në këtë aktgjykim të Gjykatës, të cilat njohin të drejtën e kontrollit preventiv të marrëveshjeve ndërkombëtare, si: **Shqipëria**, **Bullgaria**, **Kroacia** etj.[123] Në praktikën e vet gjyqësore, **Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë** me **Vendimin nr. 15/2009***,* të 15 prillit 2010, ka shpallur si antikushtetuese një marrëveshje të paratifikuar, të lidhur ndërmjet këtij vendi dhe **Greqisë**, e cila synonte caktimin e kufijve të tyre në det.[124]

---

[121] Legjislacioni implementues mund të ketë formën e vendimit të Qeverisë, siç ishte rasti me Vendimin e Qeverisë për Marrëveshjen për Telekomunikacionin, e përmendur më lart. Ai legjislacion mund ta ketë formën e ligjit të kualifikuar, siç ishte rasti me **Ligjin nr. 05/L-053 për Dhomat Speciale dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar**, miratuar nga **Kuvendi i Kosovës** më 3 gusht 2015. Në fund fare, ky legjislacion implementues mund të ketë natyrën e marrëveshjes shtesë në vazhdim të implementimit të një detyrimi primar origjinal ndërkombëtar, i cili nuk është marrëveshje ndërkombëtare por që ka lindur si pasojë e një vendimi të një organi ndërkombëtar, siç është rasti me **Vendimin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës** që miraton Raportin dok. 12462, të 7 janarit 2011, lidhur me pretendimet për krimet e kryera ndërkufitare dhe ndërkombëtare gjatë konfliktit në Kosovë dhe pas tij. Si legjislacion implementues që ka natyrën juridike të marrëveshjes ndërkombëtare që ka lindur si pasojë e implementimit të një detyrimi primar (origjinal) ndërkombëtar mund të theksohet **Marrëveshja e Përkohshme ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Holandës mbi Organizimin e Institucionit të Gjykatës Speciale të Kosovës i Zhvendosur në Holandë**, e lidhur në Prishtinë, më 26 janar 2016. Kjo marrëveshje është ratifikuar me *Dekretin DMN- 003-2016 të Presidentes së Republikës së Kosovës për Ratifikim të Marrëveshjes Ndërkombëtare*, i cili mban datën 3 shkurt 2016.

[122] *Rasti KO 95/13. Aktgjykim. Parashtrues: Visar Ymeri dhe 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 04/L-199 për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të Planit të zbatimit për këtë marrëveshje.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë: 9 shtator 2013. Nr. ref.: AGJ469/13.

[123] Cf. Paragrafët 48-69 të Aktgjykimit në rastin **KO 95/13**.

[124] Cf. më shumë për trajtimin elokuent të këtij rasti nga vetë raportuesi i çështjes, Xhezair Zaganjori, *Jurisprudencë dhe praktikë ndërkombëtare,* (MORAVA, Tiranë, 2011) fq. 39-52.

Janë të rralla shtetet që lejojnë kontrollin kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare pas ratifikimit të tyre të brendshëm nga parlamenti. **Polonia** dhe **Serbia** janë ndër to.[125] Në vendet që kanë një zgjidhje të tillë kushtetuese, partnerët negociues të një marrëveshje ndërkombëtare duhet të njoftohen me kohë nga negociuesit e tillë për kufizimet e tyre kushtetuese. Kjo për faktin se barrierat kushtetuese nuk mund të jenë arsye valide për anulim të marrëveshjes së lidhur ndërkombëtare, përveç nëse nga rrethanat e rastit del se palët e kanë pasur të qartë një barrierë të tillë.[126] Shtetet, si **Gjermania**, për t'i ikur kësaj situate të pakëndshme, me Aktgjykimin e 29 qershorit 2009 lidhur me **Traktatin e Lisbonës**, kanë ofruar zgjidhje subtile që në mënyrë të tërthortë pranojnë mundësinë praktike të kontrollit kushtetues të marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare, por vetëm nëse organi përfaqësues ka vepruar **ultra vires**, qoftë me rastin e ratifikimit të brendshëm ose gjatë implementimit të marrëveshjes ndërkombëtare ende të paratifikuar. Quhet se ekziston veprimi **ultra vires** i organit kushtetues, sipas verdiktit të **Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë**, në rastet kur një marrëveshje e lidhur ndërkombëtare prek në dispozitat kryesore kushtetuese të neneve 1 dhe 20 lidhur me nenin 79 të **Ligjit Themelor të Gjermanisë.** Këto nene përbëjnë identitetin kushtetues gjerman.[127]

Nëse marrëveshja ndërkombëtare futet në sistemin e brendshëm juridik nëpërmjet një ligji për ratifikim të brendshëm, por dispozitat e saj nuk kanë natyrë vetekzekutuese, atëherë kjo do të thotë se ajo marrëveshje e ratifikuar nuk mund të zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë sepse nuk krijon të drejta e detyrime për palët private dhe për palët e tjera. Një situatë e tillë kërkon nxjerrjen e një norme shtesë implementuese të marrëveshjes së ratifikuar me ligj. Kjo normë implementuese, sikundër u tha më sipër, zakonisht ka karakter juridiko-kushtetues të një norme të brendshme (ligj, dekret, rregullore, urdhër qeverie, akt tjetër individual etj.). Në rastet kur kjo normë implementuese nuk ka natyrë juridike të brendshme, atëherë norma e dytë ndërkombëtare që implementon një detyrim ndërkombëtar origjinal ka natyrë juridike të normës sukcesive në kuptim të nenit 30 [Zbatimi i Marrëveshjeve Sukcesive Lidhur me të Njëjtën Çështje] të **KVDT**-së, nen i cili në tërësi reflekton dhe sanksionon të drejtën ndërkombëtare zakonore. Si e tillë, kjo normë implementuese e natyrës sukcesive, në asnjë rast nuk mund të sabotojë objektin dhe qëllimin e detyrimit të parë të përmbajtur në marrëveshjen e parë të ratifikuar nga organi përfaqësues me pëlqim të organit ekzekutiv. Në këso rastesh, norma e dytë ndërkombëtare shërben si normë implementuese e normës së parë, e normës bazë, e cila përmbahet në marrëveshjen e lidhur ndërkombëtare që iu është nënshtruar ratifikimit të brendshëm të organit përfaqësues, gjithnjë me pëlqimin e organit ekzekutiv. Në një raport të **Komisionit të Venecias**, duke iu referuar **Maqedonisë së Veriut**, ka vërtetuar këtë standard ndërkombëtar nga **KVDT** duke konstatuar se marrëveshjet ndërkombëtare që nuk ratifikohen nga parlamenti nuk do mend se janë pjesë përbërëse e rendit të brendshëm juridik dhe gjejnë zbatim të njëjtë si dhe ato të ratifikuarat, në vartësi të natyrës së normave që prodhojnë (të vetekzekutueshme ose jo). Me një fjalë, këto marrëveshje shpjegohen përmes **teorisë moniste** mbi marrëdhënien në mes të drejtës së brendshme dhe asaj ndërkombëtare, njëjtë si kur flitet

[125] Neni 167. 2 [Statusi Gjykatës Kushtetuese] i Kushtetutës së Serbisë të vitit 2006 thotë shprehimisht se Gjykata Kushtetuese mund të vendosë lidhur me përputhshmërinë e marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare me Kushtetutën, kurse neni 118.1 [Tribunali Kushtetues] i Kushtetutës së Polonisë të vitit 1997 stipulon të drejtën e Tribunalit që të gjykoj përputhshmërinë e ligjeve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën.

[126] Në fakt, në nenin 46 [Dispozitat e të Drejtës së Brendshme Lidhur me Kompetencën për Lidhjen e Traktateve] të **KVDT**-së, shprehimisht theksohet se zgjidhjet e brendshme kushtetuese e ligjore nuk mund të shërbejnë si bazë juridike për moszbatim të detyrimeve të marra nëpërmjet marrëveshjeve ndërkombëtare të lidhura në mënyrë të duhur.

[127] Në rastin gjerman bëhet fjalë për kontrollin kushtetues të cilin e bën **Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë** kundrejt akteve **ultra vires** të organeve kushtetuese me qëllim të mbrojtjes së **identitetit kushtetues** të **Gjermanisë** karshi **Bashkimit Evropian**. Cf. Daniel Thym, "From Ultra Vires Control to Constitutional – Identity – Review: The Lisbon Judgement and German Constitutional Court." Në Jose Maria Beneyto/Ingolf Pernice (eds.), *Europe's Constitutional Challenges in the Light of the recent Case Law of National Constitutional Courts: Lisbon and Beyond* (Nomos, Baden-Baden, 2011), fq. 45-62; Mattias Wendel, "Lisbon Before the Courts: Comparative Perspectives." Në Jose Maria Beneyto/Ingolf Pernice (eds.), *Europe's Constitutional Challenges in the Light of the recent Case Law of National Constitutional Courts,* fq. 65-106.

për marrëveshjet e ratifikuara nga parlamenti.[128] Kjo për faktin se marrëveshjet e lidhura, të cilat përmbajnë norma të tilla, zakonisht administrojnë normat e marrëveshjes së ratifikuar me qëllim të saktësimit dhe të implementimit të tyre. Normat e përmbajtura në marrëveshjet administrative lindin si pasojë e ekzistimit të dy rrethanave: e para, dispozitat e normës së marrëveshjes së ratifikuar zakonisht nuk janë mjaftë precize dhe nuk i përcaktojnë qartë dhe si duhet të drejtat dhe detyrimet e palëve; dhe, e dyta, si pasojë e kësaj pasaktësie dhe paqartësie lind edhe nevoja për hapa shtesë për vënien në jetë të normave të ratifikuara nga parlamenti (gjithnjë me prezumimin se ekziston edhe pëlqimi i ekzekutivit).

Të një natyre të tillë janë të gjitha marrëveshjet e lidhura ndërmjet **Kosovës** dhe **Serbisë** në vijim të implementimit të **Marrëveshjes së Parë**. Ndër to, më e rëndësishmja është **Marrëveshja e Dytë**, për shkak të vetë përmbajtjes së saj dhe për faktin se tanimë ekziston një prononcim i **Gjykatës Kushtetuese** lidhur me këtë përmbajtje. Ky prononcim, i cili më shumë ka shkaktuar huti se që ka sqaruar, e aq më pak të ketë zgjidhur, vendin dhe pozitën e marrëveshjeve ndërkombëtare të paratifikuara nga Kuvendi (me pëlqimin e Ekzekutivit) në sistemin juridik-kushtetues kosovar. Ky rast ka qenë një rast ideal për Gjykatën që të sqarojë përfundimisht natyrën e dispozitave të paragrafit 2, të nenit 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, dispozita që, siç thamë më herët, aspak nuk dallojnë për nga mesazhi që bartin dispozitat e ngjashme të kushtetutave të vendeve të **Evropës,** si të atyre të vendeve ish-komuniste ashtu dhe të demokracive tradicionale evropiane. Në të gjitha rastet e tjera, marrëveshjet që nuk i nënshtrohen ratifikimit të brendshëm, cilësohen si marrëveshje administrative sepse administrojnë për qëllime të implementimit një normë tjetër ndërkombëtare që gjendet në një marrëveshje ndërkombëtare e cila është lidhur dhe është ratifikuar nga organi përfaqësues me pëlqim të ekzekutivit. Marrëveshja ndërkombëtare, kur ka formën e shkruar, mund të gjendet në një instrument ratifikimi ose në disa sosh.

16.7.4. Kontrolli kushtetues i marrëveshjeve të paratifikuara ndërkombëtare

Siç mund të vërehet nga diskutimi i mësipërm, në **Kushtetutën e Kosovës** nuk ekziston qoftë dhe një dispozitë që flet për mundësinë e lejimit të kontrollit kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare, pa marrë parasysh nëse janë ratifikuar ose jo nga Kuvendi, nga Presidenti i Republikës apo nga Qeveria. Në fakt, mundësinë e ratifikimit të llojeve të caktuara të marrëveshjeve ndërkombëtare nga ana e Presidentit të Republikës e lejon shprehimisht paragrafi 2 i nenit 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës. I njëjti nen, por edhe tërë Kushtetuta, ngelen të heshtur sa i përket ratifikimit të llojeve të caktuara të marrëveshjeve ndërkombëtare nga ana e Qeverisë. Kjo nënkupton se çdo ratifikim që kryhet nga Qeveria duhet të bëhet me autorizim të Presidentit të Republikës, me kusht që fjala nuk është për marrëveshjet nga neni 18.1 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] i Kushtetutës. Nga aspekti ndërkombëtar, ndërkaq, vlen të theksohet e të sqarohet se, edhe pa këtë autorizim të Presidentit të Republikës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara ndërkombëtarisht nga Qeveria janë tërësisht valide dhe paqartësitë kushtetuese nga neni 18.2 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] i Kushtetutës nuk mund të shpërbejnë si bazë për mohimin e detyrimeve të marra ndërkombëtare.

Atëherë, si ndodhi që **Marrëveshja e Dytë** u bë objekt kontrolli kushtetues në **GJKRKS**? Përgjigja në këtë pyetje gjendet në historikun e zgjerimit të juridiksionit të **Gjykatës**, që ka ndodhur me **Aktgjykimin KO 80/10** të 7 tetorit 2010, në rastin e njohur si **Rasti Qeska**, kur Gjykata krejtësisht në mënyrë të gabuar interpretoi dispozitat e neneve 84.9 [Kompetencat e

[128] Cf. Igor Spirovski, "The Competence of the Constitutional Court to Control the Conformity of Laws With International Treaties: New Trends in Constitutional Justice." Në European Commission Through Law (Venice Commission) in co-operation with the Constitutional Court of Montenegro and the OSCE, *Seminar on The Competence of the Constitutional Court to Control the Conformity of Laws With International Treaties.* **CDL-JU(2009) 036** (Vennice Commission, **Strasbourg**, 17 November 2009).

Presidentit][129] dhe 93.10 [Kompetencat e Qeverisë][130] të Kushtetutës, sikur gjoja ato lejojnë "ngritje të çështjeve kushtetuese" pa asnjë kufizim nga ana e Presidentit dhe Qeverisë.[131] Ky ka qenë dhe ngel gabim, sepse dispozitat e sipërcekura të këtyre dy neneve kushtetuese flasin për "ngritjen e çështjeve kushtetuese" nga ana e këtyre dy organeve kushtetuese vetëm në kuadër të juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese të përcaktuar qartë me nenin 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Kosovës. Se një gjë e tillë ka qenë qëllim i hartuesve të Kushtetutës, qartë dëshmohet nga redaktimi i dispozitës tërësisht të ngjashme të nenit 135.4 [Raportimi i Avokatit të Popullit] të Kushtetutës.[132] Ani se kjo praktikë ka ndryshuar, siç u tha më sipër, vlen të shtjellohet **modus operandi** e këtij juridiksioni.

Mënyra ekstensive e interpretimit të dispozitave mbi kompetencat e Presidentit dhe të Qeverisë, të cilin e ka bërë Gjykata, në esencë ka rezultuar në atë që kompetencat e këtyre dy organeve kushtetuese të jenë përcaktuese të vetë juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese. Ky

---

129 Presidenti i Republikës së Kosovës: [...] "(9) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese".

130 Qeveria ka këto kompetenca: "[...] (10) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese".

131 Përveç rastit të parë, **Rastit Qeska**, raste të tjera që deri më sot janë vendosur nga Gjykata mbi të njëjtin arsyetim dhe logjikë janë si vijon*: Aktgjykimi i 7 tetorit 2010 në rastin nr. KO 80/10* (Kërkesa e Presidentit të Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së Tij, dr. Fatmir Sejdiu, për sqarim të kompetencave në rastin e kryetarit të Rahovecit, z. **Qazim Qeska**); *Aktgjykimi i 22 dhjetorit 2010 në rastin nr. KO 97/10* (Kërkesa e parashtruar nga Ushtruesi i Detyrës së Presidentit, z. **Jakup Krasniqi**, lidhur me mbajtjen e postit të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit dhe njëkohësisht të postit të Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Demokratike të Kosovës); *Aktgjykimi i 20 shtatorit 2011 në rastin nr. KO 98/11* (Parashtrues: Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës); *Aktgjykimi i 20 shtatorit 2012 në rastin nr. K0 57/12* (Kërkesa e Presidentes së Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së Saj, **Atifete Jahjaga,** me të cilën konteston votimin për miratimin e Ligjit nr. 04/1-084 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë të Kosovës); *Aktvendimi i 11 shkurtit 2014 në rastin nr. KO 18/14*. (Parashtrues: Vesna Mikić dhe 20 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kërkesë për "[...] *interpretim të dispozitave të Kushtetutës* së *Kosovës lidhur* me *vendet* e *rezervuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë"*); *Aktgjykimi i 1 korrikut 2014 në rastin nr. KO 103/14* (Parashtrues: Presidentja e Republikës së Kosovës. Përkitazi me vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 84 (14) [Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës); *Aktgjykimi i 23 dhjetorit 2015 në rastin nr. KO 130/15* (Parashtrues: Presidentja e Republikës së Kosovës. Lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar *"Asociacioni/Bashkësia i komunave* me *shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore"* me frymën e Kushtetutës, me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës).

132 Avokati Popullit: "(4)... ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute". Pozicionet si në këtë punim, autori i këtyre rreshtave i ka mbrojtur që në dhjetor të vitit 2013 në librin koautorial ku komentohet për herë të parë Kushtetuta e vitit 2008. Dorëshkrimi i librit, në fakt, për botim qe dorëzuar gjashtë muaj më herët. Cf. Enver Hasani-Ivan Čukalović, *Kushtetuta e Kosovës. Komentar* (GIZ, në emër të Ministrisë Gjermane Federale për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, Prishtinë, 2013), fq. 400-401, lidhur me fq. 665. Këtë e theksoj këtu për të dëshmuar se me kohë autori i parë i këtij libri me kohë e ka pasur shumë të qartë se ky lloj aktivizmi gjyqësor, me kalimin e kohës mund të bëhej barrë e padurueshme për gjyqësinë kushtetuese kosovare. Çdo ditë e më shumë u pa se ky qëndrim ka qenë i drejtë ngaqë gjyqësia kushtetuese kosovare nuk ka as kapacitet profesional dhe intelektual, e as vullnet dhe sinqeritet kolegjial, për t'u ballafaquar me një juridiksion të tillë metafizik për çështje të papërcaktuara që nuk kanë asnjë funksion pos akomodimin dhe shpëtimin e lëkurës së politikanëve obskurantist të shtetit të Kosovës, shtet që ende është në ndërtim e sipër.

Kjo u vërtetuara në vitin 2018, kur **Gjykata Kushtetuese** me një aktvendim "ndryshoi" këtë praktikë dhe hjeku dorë nga ky juridiksion, duke anuluar të drejtën e Presidentit të Republikës dhe Qeverisë për të ngritur pyetje kushtetuese "në të thatë", përkatësisht pa pasur një rast ose mosmarrëveshje konkrete që materializohet në një akt juridik shtetëror / publik. Cf. **Rasti KO 79/18**.

E vumë në thonjëza "ndryshoi" si cilësim sepse, në thelb, ky vendim ka defekt serioz profesional meqë me aktvendim nuk mund të bëhet ndryshimi i praktikës gjyqësore të ndërtuar me vendim meritor, aktgjykim. Përveç kësaj të mete, në aktvendim ka defekte edhe më serioze të natyrës profesionale sepse citohet rasti gjerman dhe mënyra si ka ndryshuar praktika gjermane e dhënies së mendimeve interpretative përmes ligjit, gjë që nuk ka qenë rasti në Kosovë: në rastin tonë, praktika e dhënies së interpretimeve me karakter këshillues për Presidentin dhe Qeverinë u krijua në rastin **Qeska**, pa asnjë bazë në ndonjë dispozitë ligjore, kurse anulimi i praktikës u bë bërë arbitrarisht me një vendim që nuk ka natyrë meritore dhe që realisht nuk mund të ndryshoj precedentin e krijuar siç duhet me aktgjykim. Sido që të jetë, ndërprerja e një praktike të tillë, abdikimi i saj, përbën një lajm të mirë për gjyqësinë kushtetuese në Kosovë sepse i lejon politikës që vetë të zgjidhë problemet që kanë natyrë thellësisht politike dhe të merr përgjegjësinë për to.

ngatërrim konceptual i juridiksionit me kompetencën,[133] më shumë se kaq, bëri që cila palë e autorizuar të jetë përcaktues i lejueshmërisë së ngritjes së çdo çështjeje kushtetuese në rastet kur ajo ngrihet **in concreto** nga Presidenti apo nga Qeveria e Kosovës. E vërteta është se, siç u tha, këto dy organe kushtetuese kanë të drejtë që të jenë palë e autorizuar vetëm në çështjet e parashikuara nga neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës, si palë të privilegjuara që nuk kanë nevojë të provojnë ekzistimin e një interesi juridik për ngritjen e çështjeve në Gjykatën Kushtetuese. Ajo çfarë ka ndodhur me vendimin në rastin **Qeska,** ndërkaq, konsistonte në faktin se këto dy organe kushtetuese u lejuan të kërkojnë nxjerrjen e vendimeve interpretative dhe këshilluese për punën që bëjnë Presidenti dhe Qeveria pa asnjë kufizim material nga neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës. Kjo nënkuptonte se Gjykata duhej të ndihmonte këto dy organe për të kryer punët e tyre të përditshme duke i këshilluar me vendime këshillëdhënëse, pa ekzistuar asnjë akt juridik material më i ulët se Kushtetuta si objekt analize nëse bie ose jo në kundërshtim më Kushtetutën.

Autorizimi për të nxjerrë vendime interpretative dhe këshillëdhënëse jashtë autorizimit shprehimor të tekstit material të Kushtetutës, është i njohur në praktikën e disa vendeve në Evropë, si: **Bullgaria**, **Italia** etj. Mirëpo, me kalimin e kohës, gradualisht, shtetet e tilla i kanë përcaktuar rregullat shtesë me qëllim të konstitucionalizimit të këtij aktiviteti ekstensiv të gjykatave të tyre kushtetuese. Edhe në **Kosovë**, siç u tha, Gjykata Kushtetuese ka braktisur këtë praktikë të dhënies së vendimeve interpretative të karakterit këshillëdhënës me vendimin e vet në rastin **KO 79/18**.[134] Më këtë vendim, që është vërtetuar më pastaj në disa raste të tjera, Gjykata e ka bërë të qartë se asnjë juridiksion tjetër jashtë atij të nenit 113 të Kushtetutës nuk ekziston në dobi të Presidentit dhe Qeverisë së Republikës. Kjo nënkupton se duhet të ketë një akt juridik apo një veprim konkret që duhet të jetë objekt i kontrollit kushtetuese dhe jo të vihet në lëvizje Gjykata Kushtetuese përmes pyetjeve thelbësisht hipotetike.

Duke përfituar nga kjo gjendje kushtetuese e krijuar nga vetë Gjykata Kushtetuese gjatë një periudhe të caktuar të punës së saj, **Marrëveshja e Dytë** pat përfunduar në Gjykatë si një "çështje kushtetuese", e ngritur nga presidentja e Republikës, znj. **Atifete Jahjaga**. Presidentja në kërkesën e saj pohonte në mënyrë krejt hipotetike ekzistimin e **Marrëveshjes së Dytë**, duke e cilësuar atë si diçka që ende nuk është pjesë e sistemit juridik kosovar, meqë asnjëherë nuk është publikuar në **Gazetë Zyrtare** e as që ka filluar zbatimi i saj. Kjo, megjithatë, nuk e pengoi Gjykatën që të merret me dispozitat krejt konkrete të **Marrëveshjes së Dytë**, duke e konsideruar të njëjtën si një dokument ekzistues operativ brenda sistemit juridik-kushtetues kosovar. I tërë teksti i këtij aktgjykimit flet me terma këshillues, hipotetikë për të ardhmen, duke i dhënë udhëzime konfuze Qeverisë për mënyrën e implementimit të **Marrëveshjes së Dytë**, si dhe për formën që duhet të ketë akti juridik që duhet të implementojë jo **Marrëveshjen e Dytë**, e cila efektivisht ishte objekt i kontrollit kushtetues, por **Marrëveshjen e Parë** që asnjëherë nuk ka mundur të jetë objekt i kontrollit kushtetues për arsye të pengesave kushtetuese për një gjë të tillë (mungesa e juridiksionit **ratione materiae**), siç

[133] Kjo, megjithatë, nuk do të thotë se gjetiu, në praktikën komparative të gjyqësisë kushtetuese, nuk ka pasur zgjerim të juridiksionit fillestar (origjinal) të gjykatave kushtetuese jashtë përcaktimeve të teksteve të kushtetutave nacionale. Përkundrazi, një gjë e tillë, e njohur si aktivizëm gjyqësor, ka ekzistuar dhe eksiton në të gjitha kontinentet e botës ku ka gjyqësi kushtetuese dhe ky zgjerim juridiksioni në disa raste ka marrë përmasa enorme shqetësuese ku gjykatat kanë luajtur rolin e gjykatave të faktit dhe arbitrit në çështjet nga më të thjeshta deri te ato që kanë pasur një natyrë të theksuar të pastër politike. Shih më shumë për këtë në studimin e jashtëzakonshëm ku jepet pasqyra komparative të kësaj çështje, Allan R. Brewer-Carias, *Constitutional Courts as Positive Legislators, A Comparative Law Study* (Cambridge University Press: Cambridge, 2011). Në kapitullin 5 ["Gjykatat kushtetuese si ligjvënës në çështjet e kontrollit kushtetues] autori flet gjerësisht për praktikën komparative të gjyqësisë kushtetuese nga e cila praktikë shumë qartë shihet se gjykatat kanë krijuar juridiksion material plotësues për kontroll kushtetues në rastet që fare nuk kanë qenë të përcaktuara me juridiksionin e tyre origjinal. E njëjta gjë vlen edhe për zgjerimin e juridiksionit të tyre për sa i përket aspekteve procedurale të kontrollit kushtetues.

[134] Cf. fusnota 71, **supra,** dhe teksti që e shoqëron.

është konstatuar nga vetë Gjykata me aktgjykimin për **Marrëveshjen e Parë**.[135] Me këtë veprim, Gjykata ka përdorur **Marrëveshjen e Parë** si një trampolinë arsyetuese për të folur për **Marrëveshjen e Parë**, duke i cilësuar detyrimet që dalin nga ajo, pra formimi i **Asociacionit të Komunave Serbe** (**AKS**) si detyrime ndërkombëtare që duhet vënë në jetë.[136] Se formimi i Asociacionit përbën një detyrim ndërkombëtar të Kosovës nuk mund të vihet në pyetje, sepse vetë akti i ratifikimit parlamentar të **Marrëveshjes së Parë** ka konfirmuar një gjë të tillë. Pikërisht, argumenti i moslejueshmërisë së kontrollit represiv të marrëveshjeve ndërkombëtare në praktikën komparative kushtetuese, bazohet në aktin e ratifikimit të brendshëm parlamentar që zakonisht kërkon një shumicë të kualifikuar, krahas pëlqimit të ekzekutivit. Vetë akti i ratifikimit parlamentar shërben si zëvendësim i kontrollit kushtetues dhe si argument kundër çdo kontrolli kushtetues represiv, pra pas votimit me shumicë të kualifikuar nga ana a Parlamentit të një marrëveshjeje ndërkombëtare, gjithnjë duke supozuar se ekziston në mënyrë simultane edhe pëlqimi i ekzekutivit.

Konstatimi në pjesën operative II, nga ana e Gjykatës, se duhet të formohet **AKS**, i cili del si konkluzion i pjesës arsyetuese të aktgjykimit në të cilin asnjë precedent komparativ nuk citohet në favor të këtij konkluzioni, nuk thotë asgjë tjetër veçse deklaron një detyrim ekzistues ndërkombëtar të Kosovës, i marrë nëpërmjet ratifikimit parlamentar të një marrëveshjeje ndërkombëtare konform nenit 18.1 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, duke e marrë kështu rolin e një organi të vlerësimit ndërkombëtar të "kushtetutshmërisë ndërkombëtare", të detyrimeve të marra ndërkombëtarisht nga ana e shtetit të Kosovës. Në fakt, i vetmi referim në burim komparativ gjendet në paragrafin 146 të Aktgjykimit **KO 130/15**, i cili fare nuk ka të bëjë me arsyetimin e pjesës që mëton ta arsyetojë, aq më pak me pjesën e tij operative.

Kjo nuk do të thotë se referimet komparative janë **a priori** të shëndetshme, sepse jo rrallë ato mund të përdoren për të konfirmuar një rrugë të drejtë që e kanë marrë vendet e tjera. Por, anasjelltas, përdorimi i doktrinës dhe i precedentit të huaj mund të përdoret për të vazhduar me ndjekjen e një rruge të gabuar dhe për të mohuar detyrimet kushtetuese të vendit të caktuar, me përdorimin e mekanizmave të brendshëm kushtetues. Rasti i një aktgjykimi, të cilin e nxori **Gjykata Kushtetues e Federatës Ruse** më 14 korrik 2015 është një shembull tipik i kësaj praktike të përdorimit të gabuar të praktikës së jashtme gjyqësore për të mohuar detyrimet ndërkombëtare të marra përsipër përmes marrëveshjeve ndërkombëtare.[137] Me këtë aktgjykim, Gjykata e ka bërë të qartë se, në **Rusi**, ani se ka një pranim formal të monizmit sa i përket vendit e rolit të marrëveshjeve ndërkombëtare në sistemin juridiko-kushtetues rus,

---

135 Cf. Pikën III të pjesës operative të Aktgjykimit në rastin **KO 95/13.**

136 Cf. Pikën II të pjesës operative të Aktgjykimit në rastin **KO 130/15**.

137 Cf. *Judgment No. 21 – P/2015of 14 July 2015 of the Constitutional Cout of the Russian Federation Circulated as a document of the Venice Commission CDL-REF (2016) 019. Strasbourg, 23 February 2016 (Opinion No. 832/2015).* Kjo qasje ruse ka zhgënjyer jo vetëm anëtarët e plenares së 106 të Komisionit të Venecias, përfshirë autorin e këtyre rreshtave si përfaqësues i **Kosovës** aty, e mbajtur më 11 -12 mars 2016 në **Venedik**, por edhe autorët rus që kishin shkruar më herët me aq zell e krenari për largimin rus nga izolimi ndërkombëtar dhe përqafimin e teorisë moniste në Kushtetutën e vitit 1993 në këtë vend, fill pas mbarimit të Luftës së Ftohët. Cf. Gennady M. Danilenko, "The New Russian Constitution and International Law". *American Journal of International Law* Vol. 88 No. 3 (July 1994) fq. 451-470.
Rusia edhe mund ta ketë një luks të tillë dhe të mohojë detyrimet e marra ndërkombëtare. Por, vendet e vogla si **Kosova** duhet të jenë më balancuese kur gjykojnë detyrimet ndërkombëtare që kanë marrë kundruall respektimit të dispozitave të kushtetutave të tyre. Asnjëherë nuk duhet të vihet në pyetje respektimi i kushtetutës nacionale, nga të gjithë. Ajo që duhet të vihet në pyetje është fakti se me rastin e gjykimit duhet të kryhet një balancim ndërmjet detyrimeve ndërkombëtare të marra dhe kushtetutës së vendit. Shih më shumë, për rolin pozitiv dhe negativ të doktrinës dhe të precedentit komparativ në të drejtën kushtetuese, librin elokuent të Vicki C. Jackson, *Constitutional Engagement in a Transnational Era* (Oxford University Press: Oxford, 2010). Në kapitullin 1 ["Rezistimi i Transnacionales"], autorja flet gjerësisht për modalitetet e rezistimit të përdorimit të burimeve të jashtme, doktrinare e nga praktika gjyqësore, si dhe për arsyet e ndryshme të këtij rezistimi. Nganjëherë, ky rezistim është fisnik dhe i dobishëm, siç është rasti me shtetet e reja në krijim e sipër, por në disa mund të jetë vetizolues dhe vetëshkatërrues për shoqërinë që ndjek një rrugë të tillë.

megjithatë në praktikë kjo nuk është kështu. Duke përdorur praktikën gjermane, austriake e italiane, Gjykata ka mohuar detyrimet ndërkombëtare të **Rusisë** për sa i përket zbatimit të **KEDNJ**.[138]

Përveç kësaj, në vijim të diskutimit tonë si më sipër, një kontroll represiv kushtetues nuk do të ishte në interes të shtetit sepse do ta dëmtonte seriozisht kapacitetin kontraktues të tij në planin ndërkombëtar, siç e ka konstatuar vetë **Hans Kelsen** në vitin tanimë të largët 1929.[139] Ka qenë pikërisht ky rol që nuk duhet ta ketë asnjëherë asnjë gjykatë kushtetuese. Ngjashëm me **Hans Kelsen** ka thënë edhe vetë Gjykata Kushtetuese, duke u bazuar në praktikën komparative kushtetuese, në Aktgjykimin **KO 95/13**, të 9 shtatorit 2013.[140] Mënyra e qasjes në **Aktgjykimin KO 130/15**, pa asnjë dyshim që paraqet marrje nga ana e Gjykatës të një roli kështillëdhënës dhe interpretativ. Në këtë rast, njësoj si në **Aktgjykimin KO 95/13**, Gjykata është dashur ta luaj rolin e arbitrit të qartë në zgjidhjen e çdo çështjeje kontestuese kushtetuese që parashtrohet për zgjidhje nga palët e autorizuara dhe sipas procedurave të përcaktuara me nenin 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës.

Kjo nuk do të thotë se nuk mund të ketë kontroll kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare të lidhura sipas nenit 18.2 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës. Përkundrazi, mendojmë se një gjë e tillë duhet të ndodhë pikërisht për faktin se mungon ratifikimi parlamentar i këtyre llojeve të marrëveshjeve dhe se çdo herë ekziston rreziku real që Presidenti dhe Qeveria të veprojnë **ultra vires**, me ose pa dashje, në vijim të zbatimit të kompetencave të tyre kushtetuese. Këtë rrezik e ka pasur parasysh, në mënyrë të ngjashme, edhe **GJKGje** në rastin e diskutuar më herët, **Lisbon Treaty**,[141] kur ka arsyetuar duke theksuar se mund të jetë kompetente për të bërë kontrollin kushtetues të detyrimeve të marra ndërkombëtare në rastet kur organet kushtetuese jo përfaqësuese (ekzekutivi) tejkalojnë kompetencat e tyre dhe veprojnë **ultra vires** duke prekur dispozitat kushtetuese gjermane që cilësohen si përbërëse të **identitetit kushtetues gjerman**. Këtë është dashur ta bëjë edhe **GJKRKS**, përkatësisht t'i cilësoj si jo kushtetuese dispozitat konkrete të **Marrëveshjes së Dytë**, duke i nxjerrë të njëjtat jashtë rendit juridik-kushtetues kosovar. Në të njëjtën kohë, Gjykata është dashur t'u tregojë organeve kushtetuese që janë në ngarkesë më punët e jashtme se çdo herë kur hyjnë në detyrime ndërkombëtare duhet t'i kenë parasysh kufizimet kushtetuese dhe që në të njëjtën kohë kufizimet e tilla duhet t'ua bëjnë me dije edhe partnerëve ndërkombëtarë me rastin e negocimeve dhe me rastin e marrjes së çdo detyrimi ndërkombëtar.[142]

Kjo është dashur të thuhet nga Gjykata me rastin e vendosjes për **Marrëveshjen e Dytë**, pra t'u tregohet organeve kushtetuese se cilat janë kufizimet kushtetuese me rastin e negocimit dhe të lidhjes së mar-

---

138 Që nga viti 2015 ka nisur një **putinizim** (sipas emrit të presidentit rus **Vladimir Putin**) i sistemit kushtetues të Rusisë. Kjo është reflektuar në veçanti në gjyqësinë kushtetuese të këtij vendi dhe detyrimeve të tij ndërkombëtare kundrejt **KEDNJ**. Esenca e kësaj qasjeje ruse ka të bëj me mohimin e verdikteve të Gjykatës së Strasburgut kur ato nuk përkojnë me interesat ruse dhe kur synojnë forcimin e sundimit të ligjit në këtë vend përmes vënies në jetë të standardeve të **KEDNJ** mbi liritë dhe të drejtat e njeriut. Ky refuzim rus bëhet duke manipuluar me praktikat gjyqësore të vendeve më të përparuara evropiane, **Austris**ë, **Gjermanisë** dhe **Italisë**, duke përdorur precedentet e tyre si provë për të mbështetur obstruksionet e detyrimeve ruse si palë në **KEDNJ**. Cf. më shumë për këtë në punimet hlumtuese akademike si vijon: Rize L. Glas, "The Boundaries to Dialogue with the European Court of Human Rights". Në Wolfgang Benedek, Philip Czech, Lisa Heschl, Karin Lukas and Manfred Nowak (eds.), *European Yearbook on Human Rights* (Intersentia: Cambridge, Antwerp, Chicago, Vienna, 2018) fq. 287-317 në. fq. 308-310; Konstantsin Dzehtsiarou and Filippo Fontanelli, "Unprincipled Disobedience to International Decisions: A Primer from teh Russian Constitutional Court". Në Wolfgang Benedek, Philip Czech, Lisa Heschl, Karin Lukas and Manfred Nowak (eds.), *European Yearbook on Human Rights*, 319-341; Lauri Mälksooand Wolfgant Benedek (eds.), *Russia and the European Court of Human Rights – The Strasbourg Effect* (Cambridge University Press: Cambridge, 2018), në vecanti pjesët II dhe III, të cilat formojnë pjesën kyçe të librit të autorëve (ku autorët hulumtojnë marrëdhënien dhe ndërveprimin në mes të **GJEDNJ** dhe gjyqësisë së rregullt dhe kushtetuese ruse; në fund japin edhe pikëpamjet e dy gjyqtarëve rus lidhur me ndikimin që ka pasur **Rusia** në sistemin e **Strasburgut)**.

139 Cituar sipas Olivera Vucic, *Austrijsko ustavno sudstvo – čuvar federacije i ustava,* fq. 201, fusnota 269.

140 Paragrafët 95-101 e Aktgjykimit në rastin **KO 130/15**.

141 Shih gjithashtu: Leonard F.M. Besselink, "National and constitutional identity before and after Lisbon". *Utrecht Law Review* Volume 6, Issue 3 (November) 2010 fq. 36-49.

142 Këtë e ka bërë në mënyrë të shkëlqyeshme **Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë**, në vendimin e komentuar në këtë kapitull. Cf. fusnota nr. 111, **supra**, dhe komentet tona aty.

rëveshjeve ndërkombëtare të të gjitha llojeve, jo vetëm të atyre nga paragrafi 2 i nenit 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës. Nuk ka relevancë dhe nuk ndihmon organet kushtetuese të Kosovës nëse atyre u tregohet **post festum** se kanë cenuar dispozitat e caktuara të Kushtetutës së Kosovës me rastin e veprimit të tyre si aktorë të marrëdhënieve ndërkombëtare. Ajo që ndihmon shumë është qartësimi i secilit kufizim kushtetues, sa më shumë që të jetë e mundur, në mënyrë që kur të ndodhë përsëritja e situatave të ngjashme vendimet nga e kaluara të shërbejnë si një udhërrëfyes për mospërsëritjen e gabimeve të njëjta. Këtë mision e kanë gjykatat kushtetuese, si dhe gjykatat supreme në rastet kur ushtrojnë edhe juridiksion kushtetues. Ndryshe do të duhej çdo ditë të shkruhej nga një kushtetutë, me sa më shumë detaje, në mënyrë që të parashihen e të sanksionohen gjërat e përditshme. Kjo do të thotë rritje enorme e vëllimin fizik të tekstit kushtetues, deri në përmasat e vëllimit në të cilin është shkruar **Epi i Gilgameshit** me mijëra vjet para erës sonë. Në një rast të tillë, teksti kushtetues i secilës ditë, përveç që do të ishte i gjatë dhe i pakuptimtë, ai as nuk do të kishte përmbajtje kushtetuese por vetëm epike, njësoj si **Epi i Gilgameshit.**

16.8. Rasti Manastirit të Deçanit

Vendimi i Gjykatës në rastin e **Manastirit të Deçanit** përbën njërin ndër vendimet e rralla të Gjykatës, për ekzekutimin e të cilit nuk ka pasur dhe ende nuk ka gatishmëri (deri në momentin e shkrimit së këtyre rreshtave), si nga ana e palëve të afektuara me të cilat ka të bëj vendimi, **Komuna e Deçanit**, ashtu edhe nga ana e dy ndërmarrjeve shoqërore që kanë qenë përfitues të vendimeve të anuluara.

Në një vëllim prej 94 paragrafëve, plus pjesa operative e tij, të shkruara në 18 faqe, ky vendim ka një strukturë argumentuese **këmbët e karriges**, ku secili argument në vetvete përbën argument autonom dhe mund të përdoret në mënyrë të pavarur për të gjetur shkeljen kushtetuese me pasojë anulimin e vendimit të kontestuar.

Vendimi është marrë me shumicë votash.[143] Objekt kontrolli kushtetues kanë qenë dy vendime meritore të datës 12 qershor 2015 të **Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës** (**Kolegji i Ankesave**), kushtetutshmërinë e të cilëve e ka kontestuar **Manastiri i Deçanit**. Argumenti kryesor i Manastirit ka qenë se vendimet e kontestuara ishin marrë në kundërshtim me parimin **res judicata**, si një ndër përbërësit fundamental të parimit të sigurisë juridike, i cili parim, në të njëjtën kohë, paraqet shtyllën mbështetëse të një parimi tjetër të rëndësishëm kushtetues – parimi i sundimit të ligjit.[144] Manastiri kishte vënë në dukje cenimin edhe të lirive dhe të drejtave të tjera kushtetuese, të parashikuara në nenet si vijon të Kushtetutës së vitit 2008:

- neni 24 [“Barazia Para Ligjit”];
- neni 31 [“E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm”];
- neni 32 [“E Drejta për Mjete Juridike”];
- neni 46 [“Mbrojtja e Pronës”];
- neni 54 [“Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave”] lidhur me nenin 13 [“E drejta për mjet efektiv”] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (**KEDNJ**).[145]

Në pjesën e arsyetimit të meritave të rastit dhe në pjesën operative të vendimit të saj, Gjykata nuk ka hyrë në analizimin e cenimit të lirive dhe të drejtave të tjera kushtetuese përveç të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm nga neni 31.2 [“E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm”] lidhur me nenin 6.1 [“E Drejta për Gjykim të Drejtë”] të **KEDNJ.**[146] Kjo për faktin se gjetja e shkeljes kushtetuese si më sipër ka përbërë një bazë të mjaftueshme për anulim të dy vendimeve të kontestuara të **Kolegjit të Apelit**. Ka ekzistuar, përveç kësaj, edhe

[143] Paragrafi 17 i Aktgjykimit në rastin e **Manastirit të Deçanit.**

[144] Paragrafët 47-51 të Aktgjykimit në rastin e **Manastirit të Deçanit**.

[145] Paragrafi 3 i Aktgjykimit në rastin e **Manastirit të Deçanit**.

[146] Paragrafët 92, 94 dhe pjesët operative II & III të Aktgjykimit në rastin e **Manastirit të Deçanit.**

një tjetër arsye që e ka bërë të pamjaftueshme shqyrtimin dhe vendosjen për të drejtat tjera kushtetuese të parashtruesit të kërkesës, **Manastirit të Deçanit**: vetë natyra e të drejtës së shkelur kushtetuese për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm objektivisht absorbon shkeljet tjera të pretenduara sepse të njëjtat përbëjnë derivat të kësaj të drejte të shkelur. E thënë me fjalë të tjera, shkelja e drejtës për pronë, barazi para ligjit dhe barazi të armëve, të marra së bashku, ka ndodhur si rezultat i cenimit të së drejtës kushtetuese për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, jo anasjelltas.

Arsyeja për anulim të vendimeve si më sipër të **Kolegjit të Apelit** konsistonte në rihapjen nga ana e këtij Kolegji të rasteve të vendosura me vendim të formës së prerë nga ana e **Dhomës së Posaçme** dhe e **Kolegjit të Apelit** që vepronin në kuadër të **Gjykatës Supreme**, por sipas rregullave të **UNMIK-**ut, ku **AKM** ka paraqitur subjektin e vetëm të autorizuar, përmes zyrës për çështje juridike, për t'u paraqitur si palë në procedurat pranë **Dhomës së Posaçme** dhe pranë **Kolegjit të Apelit** në çështjet që kanë të bëjnë me privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore.[147] **Kolegji i Apelit,** i cili vepronte mbi bazën e Kushtetutës së vitit 2008 dhe ligjeve vendore, i kishte trajtuar këto vendime të autoriteteve hibride gjyqësore si jo-ligjore dhe kishte kthyer tërë çështjen në rigjykim në **Deçan** - në dega e **Gjykatës Themelore të Pejë**. Ky Kolegj nuk e kishte pranuar **Manastirin e Deçanit** si palë në procedurë meqë, sipas tij, ai paraqiste një organizatë fetare kurse **Dhoma e Posaçme** dhe **Kolegji i Apelit** kishin juridiksion vetëm për çështjen e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore. Po ashtu, Kolegji nuk kishte pranuar as **Komunën e Deçanit** dhe **AKM-në** si palë në procedurë me arsyetim se fjala ishte për autoritete publike, jo për një ndërmarrje shoqërore.[148]

Këto konstatime të **Kolegjit të Apelit** binin ndesh me vendimet e mëparshme të vitit 2008 të **Dhomës së Posaçme,** që vepronte brenda **Gjykatës Supreme të Kosovës**. Këto vendime ia kishin njohur Manastirit të drejtën mbi pronën, të cilën e kërkonin dy ndërmarrjet kosovare **Apiko** dhe **Iliria**. Manastiri kishe fituar ato prona sipas një marrëveshje për dhuratë të dhënë nga Qeveria e Serbisë në vitin 1997, duke ua kthyer pronat gjoja të marra përmes shpronësimit nga regjimi komunist pas **Luftës së Dytë Botërore**. Këtë marrëveshje për dhuratën i kishin kontestuar pas **Luftës së Kosovës** (shkurt 1998 - qershor 1999) dy ndërmarrjet shoqërore si më sipër dhe **Komuna e Deçanit**. Gjatë procedurës pranë **Dhomës së Posaçme**, si një organ hibrid, për të cilin kemi folur lartë në këtë kapitull kur kemi trajtuar rastin e **AKP**-së, **Komuna e Deçanit** dhe dy ndërmarrjet në fjalë janë tërhequr nga procedura ashtu që vetëm **AKM** ka përfaqësuar palët në procedurë, përkatësisht dy ndërmarrjet e sipërcekura shoqërore **Apiko** dhe **Iliria**, të cilat po kontestonin pronën dhuruar **Manastirit të Deçanit**. Kontestimi i tyre bazohej në faktin se ai dhurim ishte bërë mbi baza diskriminuese. Këto argumente kjo Dhomë nuk i ka pranuar dhe ka vendosur që t'ia njoh të drejtën e pronësisë **Manastirit të Deçanit.**[149]

Pas kësaj njohje, çështjet e privatizimit në tërësi kanë kaluar në **AKP**, si përfaqësuese e ndërmarrjeve shoqërore, në krejt procedurat pranë **Dhomës së Posaçme** dhe në nivel apeli, procedura që kanë operuar dhe operojnë ende pranë **Gjykatës Supreme të Kosovës**. Kjo Dhomë ka marrë dy vendime më 12 qershor 2015, me të cilat ka prishur vendimet e **Dhomës së Posaçme**, si organ gjyqësor hibrid në kuadër të **Gjykatës Supreme**, dhe ka kthyer çështjen në rigjykim nga e para në **Deçan** ku është dega e **Gjykatës Themelore të Pejës.**[150]

Këto konstatime të **Dhomës së Posaçme**, Gjykata Kushtetuese i ka gjetur si jo kushtetuese sepse shkojnë kundër parimit **res judicata**, dhe cenojnë njërin ndër parimet themelore mbi

147 Paragrafi 29 i Aktgjykimit në rastin e **Manastirit të Deçanit.**

148 Paragrafi 45 i Aktgjykimit në rastin **Manastiri Deçanit**.

149 Paragrafët 31-32, 34 Aktgjykimit në rastin **Manastiri Deçanit.**

150 Paragrafët 35, 42-45 të Aktgjykimit në rastin e **Manastirit të Deçanit.**

sigurinë juridike dhe sundimin e ligjit. Përveç kësaj, Gjykata ka theksuar se palët e interesuara, që kishin fituar rastin në vitin 2015, pra **Komuna e Deçanit** dhe dy ndërmarrjet shoqërore, asnjëherë nuk kishin kontestuar shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese pranë Gjykatës Kushtetuese, ani se kishin pasur një mundësi të tillë. Këtë nuk e kishte bërë as **AKP**, e cila, në rastin e **AKP** që diskutuam më lart në këtë kapitull, kishte ngritur çështjen e subjektivitetit të vet juridik dhe mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese pranë **Gjykatës Kushtetuese**. Kjo rrethanë i ka mundësuar Gjykatës Kushtetuese që të arrij në konstatimin sipas të cilit **Dhoma e Posaçme** nuk të vendos për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të palëve te afektuara përmes rikthimit të çështjes në rigjykim. Kjo është kështu sepse, sipas Gjykatës, gjykatat themelore nuk janë kompetente, siç nuk është as vetë **Dhoma e Posaçme**, për të mbrojtur të drejtat kushtetuese të subjekteve të së drejtës në Kosovë. Kjo e drejtë i takon vetëm Gjykatës Kushtetuese dhe askujt tjetër. Këtë kërkesë, pra kërkesën për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, palët nuk e kanë ngritur asnjëherë në Gjykatën Kushtetuese.[151] U mor vesh, të gjitha autoritetet publike kanë detyrim që të kujdesen për mbrojtjen dhe promovimin e lirive dhe të drejtave kushtetuese. Këtu nuk bëhet fjalë për cenimin e këtij detyrimi: me këtë konstatim, Gjykata Kushtetuese vetëm ua ka bërë me dije gjykatave të rregullta se ajo dhe vetëm ajo është autoriteteti kompetente për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave kushtetuese në mënyrë autoritative dhe përfundimtare.

Sikur palët e pakënaqura, dy ndërmarrjet shoqërore dhe **Komuna e Deçanit**, të ishin paraqitur me kohë në Gjykatën Kushtetuese, në kohën sa ka qenë në vijim e sipër procedura pranë gjyqësorit të rregullt kosovar, atëherë me siguri që gjendja do të kishte qenë ndryshe. Kjo për arsye se Gjykata domosdo do të kishte e qenë e detyruar të konstatojë se **AKP** praqet subjektin e vetëm të autorizuar për t'u paraqitur si palë në procedurat pranë **Dhomës së Posaçme** dhe në procedurat e tjera që kanë të bëjnë me çështjet e privatizimit, duke afirmuar kështu vendimin e saj të mëhershëm të AKP-së, i diskutuar më sipër në këtë kapitull. Meqë ky nuk ka qenë rasti, atëherë vendimi i Gjykatës Kushtetuese që anulon dy vendimet e **Dhomës së Posaçme** në rastin e **Manastirit të Deçanit** është i drejtë nga aspekti juridik-kushtetues dhe nuk mund të kontestohet ekzekutimi i tij. Kjo edhe për faktin se, për më tepër, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veproj **sua sponte** dhe të kërkoj **ex officio** nga palët zgjerimin e kërkesës me qëllim të përfshirjes në një rast ekzistues të çështjeve të tjera që nuk janë ngritur dhe shqyrtuar në kërkesën origjinale në procedurat e zhvilluara pranë trupave të **Gjykatës Supreme**, siç kanë qenë çështjet e legjitimimit aktiv dhe pasiv të **AKM** dhe të **Manastirit të Deçanit** gjatë procedurave të procedurat e privatizimit.

16.9. Rasti zgjedhjes së Presidentit Thaçi

Rasti i zgjedhjes së **Presidentit të Republikës** është krijuar në një situatë mjaft të tensionuar politike: deputetët nga opozita, **VV** (**Lëvizja Vetëvendosje**), **AAK** (**Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës**) dhe **NISMA** (**Nisma për Kosovën**) tërë kohën sa ka zgjatur zgjedhja kanë përdorur **gas lotsjellës** dhe mjete të tjera jodemokratike për të penguar nisjen e procedurave të zgjedhjes. Kjo zgjedhje u bë pas mbarimit të mandatit të ish-Presidentes **Atifete Jahjaga** (7 prill 2011 – 7 prill 2016).[152]

Vendimi i Gjykatës në këtë rast ka formën e aktvendimit, përkatësisht të vendimit jomeritor, me të cilin Gjykata ka shpallur kërkesën si qartazi të pabazuar për faktin se "[...] parashtruesit e kërkesës nuk i kanë dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tyre se vendimi i Kuvendit "[...] për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës është në

[151] Paragrafët 62, 64 & 66 të Aktgjykimit në rastin e **Manastirit të Deçanit**.

[152] Neni 86. 2 [Zgjedhja e Presidentit] i Kushtetutës: "[...] Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës duhet të bëhet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual".

kundërshtim me nenin 86, paragrafët 4 dhe 5 të Kushtetutës".[153] Sa i përket strukturës argumentuese, ndërkaq, **vendimi ka natyrën e argumenteve kushtetuese me një rresht që ka natyrë përfundimtare** (që e mbyllë argumentin e parashtruar me qëllim të vërtetimit të fakteve kushtetuese). Kjo strukturë, siç kemi vënë në re në seksionin **15.3** të kapitullit paraprak, njihet ndryshe si argumenti **rrathët lidhës zinxhiror** dhe, si i tillë, dominon narrativin e këtij vendimi. Këtë strukturë e cilëson ekzistimi i një sërë premisash dhe përfundimesh të ndërvarura që formojnë një argument të qëndrueshëm në vetvete, në mënyrë të pavarur dhe lineare deri në arritjen e verdiktit përfundimtar.

Në vijim si më sipër, Gjykata në pjesët e para bën përmbledhjen e zakonshme të fakteve të rastit, përmbledhje së cilës i paraprinë përshkrimi i procedurës në Gjykatë. Pas kësaj, në aktvendim jepen argumentet kryesore të palës që kërkon kontrollin kushtetues të vendimit të Kuvendit të Kosovës mbi zgjedhjen e Presidentit të Republikës. Në këtë kuptim, parashtruesit e kërkesës janë ankuar për shkak se, gjate tri raundeve të votimit, nuk ishin përmbushur kërkesat nga neni 86, paragrafi 4 ["Zgjedhja e Presidentit"] i Kushtetutës. Kjo kërkesë e parashtruesit ka në strukturën e vet argumentuese, të përshkruar si më sipër, këtë arsyetim:

"[...] Bazuar në rezultatet e votimit të raundit të tretë, i cili përshkohej, si dy raundet e para të votimit, me shkelje të Kushtetutës, respektivisht nenit 86 (4) dhe (5), nenit 27 të Rregullores së Kuvendit, Kryetari i Kuvendit shpall zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës. Në këtë rast, në lidhje me kuorumin e përcaktuar sipas Nenit 86 (4) për zgjedhjen e Presidentit të Republikës, në Aktgjykimin K0 29/11, të datës 30 mars 2011 (*Sabri Hamiti dhe deputetë të tjerë, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, i datës 22 shkurt 2011*), në paragrafin 85 [..] Gjykata vëren se lidhur me numrin e votave qe kërkohet për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, neni 86 (4) i Kushtetutës siguron se Presidenti i Republikës së Kosovës do të zgjidhet me dy të tretat (2/3-at e **votave të të gjithë deputeteve** (në versionin origjinal) të Kuvendit, që do të thotë së të gjithë 120 deputetet duhet te votojnë, minus ata deputetë të cilët kanë marrë leje nga Kryetari i Kuvendit, dhe kandidati i cili merr 80 ose më shumë vota nga votat e të gjithë deputetëve (në raundin e parë dhe të dytë) do të zgjidhet. Vetëm nëse nuk arrihen dy të tretat e shumicës, mbahet raundi i tretë. Neni 27 i Ligjit për deputetë dhe neni 274 i Rregullores së punës së Kuvendit, përmban formulim identik të fjalëve: 'dy të tretat (2/3) e **votave të të gjithë deputetëve** të Kuvendit'. Kërkesa eksplicite dhe konstatimi i Gjykatës Kushtetuese se 'kushti i nenit 86, që të gjithë deputetet duhet të votojnë, megjithatë nuk u plotësua' vlen edhe në rastin e seancës se datës 26 mars 2016 [Korrigjim nga Gjykata: 26 shkurt 2016]. Me fjalë të tjera, pjesëmarrja e të gjithë deputetëve në seancë nuk është vetëm detyrë e tyre, por është edhe "kusht" i domosdoshëm për vlefshmërinë e zgjedhjes [...]".[154]

Në bazë të kërkesës, parashtruesit i referohen Aktgjykimit të Gjykatës në rastin **KO 29/11**, Parashtrues **Sabri Hamiti dhe deputete te tjerë**, Aktgjykim i 30 marsit 2011. Ata konsideruan se procedura për zgjedhjen e **Presidentit të Republikës së Kosovës** është kundërkushtetuese dhe e pavlefshme, sepse, sipas tyre, në votim nuk kishin marr pjesë të gjithë 120 (njëqind e njëzet) deputetët.[155]

Në arsyetimin e vet kundër këtyre argumenteve të parashtrueseve, Gjykata ka theksuar se të njëjtin kishin keqkuptuar kuorumin dhe numrin e domosdoshëm të votave që duhet t'i fitoj një kandidat për t'u zgjedhur President i Kosovës. Në këtë kuptim, Gjykata ka thënë se kuorumi përbëhet nga shumica absolute e deputetëve të Kosovës, përveç në rastet kur kërkohen një shumicë e kualifikuar për vendimmarrje.[156] Në situata të tilla, kuorumi përcaktohet nga numri i nevojshëm i votave të kualifikuara për vendimmarrje. Përveç për zgjedhjen e Presidentit, një rast i tillë ekziston te ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare

[153] Paragrafi 76 i Aktvendimit në rastin e zgjedhjes së Presidentit **Hashim Thaçi**.

[154] Paragrafi 31 i Aktvendimit në rastin e zgjedhjes së Presidentit **Hashim Thaçi**.

[155] Paragrafi 32 i Aktvendimit në rastin e zgjedhjes së Presidentit **Hashim Thaçi.**

[156] Paragrafi 62 i Aktvendimit në rastin e zgjedhjes së Presidentit **Hashim Thaçi.**

nga neni 81.1 ["Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare"] i Kushtetutës dhe kështu me radhë. Tutje, për të qenë i vlefshëm krejt procesi, Gjykata ka sqaruar se dy raundet e para duhet të jenë kryer siç duhet, pra që në proces të kenë marrë pjesë dy të tretat e kërkuara për t'u zgjedhur **President i Republikës**. Vetëm pas kësaj mund të kalohet në raundin e tretë, siç edhe kishte ndodhur me rastin e zgjedhjes së Presidentit **Hashim Thaçi**. Kjo nënkuptonte se parashtruesit nuk kishin arritur t'i argumentonin pretendimet e tyre mbi shkeljet kushtetuese, ashtu që në fund krejt kërkesa u shpall si qartazi e pabazuar. Kjo nuk nënkuptonte se zgjedhja kishte qenë kushtetuese, por thjeshtë se palët parashtruese të kërkesës nuk kishin arritur t'i provonin argumentet e tyre nga kërkesa e parashtruar.

Në të njëjtën kohë, Gjykata e ka bërë me dije se vendimi i saj për **rastin Pacolli** ka qenë i bazuar në premisën e shkeljeve kushtetuese që në start sepse në dy raundet e para, të cilat janë të domosdoshme për të bërë të vlefshme raundin e tretë ku kërkohen shumica absolute e votave, nuk kishin marr pjesë dy të tretat e deputetëve, kusht ky i domosdoshëm dhe i barabartë me kuorumin në rastet kur bëhet zgjedhja e Presidentit të Republikës (si dhe në çdo rast kur kërkohet një shumicë e tillë e kualifikuar).[157]

Kjo si më sipër duhet kuptuar si një vendim që nuk mëton të ndryshoj precedentin e mëprashëm sepse ka natyrë jo meritore. Sikur të kishte qenë aktgjykim, pra sikur të kishte pasur merita si rast, atëherë Gjykata do të kishte pasur mundësi të arrijë në një përfundim tjetër. Një gjë e tillë do të kishte ndodhur sikur, ta zëmë, në dy raundet e para të mos kishte pasur votim nga dy të tretat e deputetëve të Kuvendit, si në rastin **Pacolli**. Në një rast të tillë, Gjykatat do të detyrohej të sqaronte se cili është statusi i dispozitave kushtetuese që kërkojnë në dy raundet e para një shumicë të kualifikuar për t'u zgjedhur President i Republikës. Këtë, në mënyrë të tërthortë, Gjykata e ka sqaruar kur ka thënë se vetëm mbajtja e duhur e dy raundeve të para mund të çoj në mënyrë të vlefshme në mbajtjen e raundit të tretë. Ky nuk ka qenë rasti me vendimin për rastin **Pacolli**, prandaj aty ka ardhur deri të anulimi i vendimit për zgjedhjen e tij, jo për shkak se në votim nuk kanë marr pjesë krejt **120** deputetët e **Kuvendit të Kosovës** por për shkak se dy raundet e para kanë qenë të pavlefshme si pasojë e mospjesëmarrjes në votim të dy të tretave të deputetëve.[158]

16.10. Rasti KQZ

Ky rast është vendosur me vendim jo meritor, përkatësisht me aktvendim. Esenca e çështjes së ngritur nga **Presidenti i Republikës** ka pasur të bëj me interpretimin e nenit 84.9 ["Kompetencat e Presidentit"] të Kushtetutës. Ky nen thotë si vijon:

"[..] Presidenti i Republikës së Kosovës:

(9) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese".

Në praktikën e mëhershme të Gjykatës, ka pasur raste kur **Presidenti i Republikës** ka përdorur këtë dispozitë për të ngritur çështje kushtetuese dhe ka marr përgjigje përmes vendimeve meritore. Siç kemi sqaruar më sipër në këtë kapitull,[159] kjo ka ndodhur edhe me **Qeverinë e Republikës së Kosovës.**[160] Formulimi i dispozitës kushtetuese lidhur me të drejtën e Qeverisë për të ngritur çështje kushtetuese pranë **Gjykatës Kushtetuese** ka qenë afërsisht i njëjtë me atë të dispozitës së nenit 84.9 si më sipër. Kjo shihet nga redaktimi i dispozitës së nenit 93.10 ["Kompetencat e Qeverisë"] të Kushtetutës, e cila thotë:

"[..] Presidenti i Republikës së Kosovës:

(9) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese [...]"

---

157 Paragrafët 69-70 të Aktvendimit në rastin e zgjedhjes së Presidentit **Hashim Thaçi.**

158 Paragrafi 69 i Aktvendimit në rastin e zgjedhjes së Presidentit **Hashim Thaçi.**

159 Një praktikë e tillë ka nisur me rastin **Qeska**. Cf. seksioni 7. 4., **supra**, në këtë kapitull.

160 Cf. *Rasti K0 98/11. Aktgjykim. Parashtrues: Qeveria e Republikës së Kosovës. Lidhur me imunitetin e deputeteve te Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit te Republikës së Kosovës, dhe anëtarëve të Qeverisë se Republikës së Kosovës*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtinë: 20 shtator 2011. Nr. Ref.: AGJ 138/11.

Si rast i fundit në praktikën e Gjykatës që është vendosur meritorisht mbi bazën e këtij formulimi kushtetues ka qenë rasti i **Asociacionit Serb**, i cili ishte ngritur nga ish-Presidentja e Kosovës, znj. **Atifete Jahjaga**. Këtë e diskutuam më sipër.

Në rastin që diskutojmë në këtë seksion, ndërkaq, Gjykata ka ndjekur një kurs tjetër, duke vendosur të ndërpresë këtë praktikë: tani e tutje vetëm dispozitat e nenit 113 ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] do të jenë të vlefshme për të lidhur juridiksionin pranë saj. Në një vend të këtij aktvendimi është thënë se, veç dispozitave të nenit 113 si më sipër, ekzistojnë edhe disa dispozita të tjera kushtetuese që mund të shërbejnë si bazë për ndërtimin e juridiksionit të Gjykatës.[161]

Sa i përket strukturës argumentuese, vendimi përmban argumente që kanë natyrën e argumenteve kushtetuese me një rresht, të cilat janë përfundimtarë kundrejt fakteve kushtetuese që mëtojnë t'i provojnë. Kjo strukturë, siç kemi vënë në re në seksionin **15.3** të kapitullit paraprak, njihet ndryshe si struktura argumentuese **rrathët lidhës zinxhiror** dhe, si e tillë, dominon narrativin e vendimit për këtë rast. Ky lloj i strukturës argumentuese karakterizohet nga ekzistimi i një sërë premisash dhe përfundimesh të ndërvarura, që së bashku formojnë një argument në vetvete, të përdorshëm në mënyrë të pavarur dhe lineare deri në arritjen e verdiktit (përfundimit) lidhur me objektin e çështjes.

Në ndërkohë që **struktura lineare argumentuese**, e përshkruar si më sipër, mund të thuhet se i shkon natyrës së aktvendimit, nisur nga fakti se kjo strukturë e dominon shumicën e arsyetimeve në vendimet jomeritore në gjyqësinë kushtetuese krahasimore, kjo nuk është kështu sa i përket arsyetimit të Gjykatës lidhur me papranueshmërinë e këtij rasti. Një fakt i tillë shpërfaq defekte që kanë të bëjnë si me formën ashtu edhe më përmbajtjen e arsyetimit të aktvendimit për këtë rast.

Sa i përket formës, vlen të thuhet se është fakt notor që ndryshimi i një precedenti të vendosur me vendim meritor nuk mund të bëhet asnjëherë me vendim jomeritor. Këtë e kemi arsyetuar gjerësisht në këtë libër në këtë kapitull më sipër. Sigurisht që nuk mund të ketë as vendosje të precedentit përmes vendimeve jomeritore për faktin se këto lloje të vendimeve nuk prekin objektin e çështjes por merren vetëm me vlerësimin nëse objekti i kontrollit kushtetues është i përshtatshëm për t'u gjykuar dhe vendosur në aspektin material (**ratione materiae**), kohor (**ratione temporis**), vendor (**ratione loci**) dhe sa i përket palëve (**ratione personae**). Edhe këtë aspekt të kompetencave, si pjesë përbërëse e instrumentariumit me të cilin zbatohet juridiksioni konkret kushtetues, e kemi sqaruar në seksionin **13.3** të kapitullit trembëdhjetë kur kemi folur për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

Sa i përket përmbajtjes së arsyetimit, ndërkaq, gjendja paraqitet edhe më e rënd në defekte. Si pikë nisëse e premisës themelore të vendimit të Gjykatës për të deklaruar kërkesën si të papranueshme ka shërbyer një **argument konspirativ**. I tillë është ky argument sepse Gjykata konstaton, pa asnjë bazë të provueshme me fakte, se gjyqësia kushtetuese kosovare e ndërtuar nga gjyqtarët e përbërjes së parë të **Gjykatës Kushtetuese** (2009-2015) e ka kuptuar termin "çështje kushtetuese" në një kuptim të gjerë. Se cili është ky kuptim i gjerë i kësaj gjenerate nuk tregohet nga Gjykata, e cila në arsyetimin e vendimit mjaftohet me një konstatim tjetër konspirativ sipas të cilit ai kuptim i gjyqtarëve të gjeneratës së parë "[...] duhet kuptuar në frymën e procesit te vendosjes se themeleve te gjyqësisë kushtetuese, si dhe të nevojës shoqërore që Gjykata në fillesat e saj të përfshihet në interpretime të neneve specifike te Kushtetutës […]". Kjo nuk është aspak e vërtetë dhe mund të vërtetohet me lehtësi nëse lexohen transkriptet e diskutimeve të gjyqtarëve kushtetues të asaj kohe, të cilat gjenden në arkivat e Gjykatës, si dhe nga shënimet origjinale të autorit të parë të këtij libri. Nga diskutimet e tilla qartë shihet se një pjesë jo e vogël e gjyqtarëve të përbërjes së parë, kur është ndeshur me vendimin e parë të kësaj natyre në rastin **Qeska** (i diskutuar në seksionin **7.4** të këtij kapitulli), ka besuar fuqishëm se redaktimi i dispozitave kushtetuese

[161] Paragrafi 57 i Aktvendimit në rastin **KQZ**: "[…] Rrjedhimisht, Gjykata thekson që e drejta e palëve të autorizuara sipas Kushtetutës, për të parashtruar kërkesa në Gjykatë, buron nga neni 113 i Kushtetutës. Përjashtim nga kjo përbën situata që ndërlidhet me nenin 62 [Përfaqësimi në Organet e Pushtetit Lokal], paragrafi 4, të Kushtetutës, si dhe rastet që mund të burojnë nga juridiksioni shtesë që mund të rregullohet me ligj, siç parashihet në nenin 113, paragrafi 10, të Kushtetutës".

të nenit 84.9 dhe 93.10 të Kushtetutës nuk lënë asnjë hapësirë për dyshim se mesazhi i tyre bën fjalë për një kompetencë dhe tagër për vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese krahas dhe në paralel me juridiksionin nga neni 113 i Kushtetutës. Se kjo është kështu, e thoshin gjyqtarët jo të paktë të kohës, vërehet qartë nga redaktimi i dispozitës së nenit 113.10 të Kushtetutës, që thotë se juridiksioni shtesë mund të caktohet edhe me ligj. Në anën tjetër, grupimi i dytë i gjyqtarëve të tjerë, përfshirë edhe autorin e parë të këtij libri, argumentonin të kundërtën duke u nisur pikërisht nga redaktimi i dispozitave të ngjashme lidhur me palët e tjera të autorizuara për të vënë në lëvizje Gjykatën ashtu dhe nga aspekti i zgjidhjeve krahasimore.[162] Në aspektin e parë, pra të palëve të privilegjuara procedurale siç janë Presidenti dhe Qeveria, argumenti themelor ka qenë ai që lidhet me personin e palës së privilegjuar të Avokatit të Popullit. Lidhur me këtë, në dispozitën e nenit 135.4 ["Raportimi i Avokatit të Popullit"] të Kushtetutës thuhet:

"[...] Avokati i Popullit ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute".

Sikur të kishte qenë synim i kushtetutëvënësit Kosovar për të dhënë një juridiksion shtesë për Presidentin dhe Qeverinë, atëherë ai do të kishte bërë një redaktim të ngjashëm me këtë. Se kjo është kështu, sipas aspektit të dytë në vijim, qartë provohet nëse analizohen zgjidhjet kushtetuese të një pjese bukur të madhe të kushtetutave nacionale, të cilat përdorin shprehjen se organi përkatës kushtetuese ka të drejtë për të vënë në lëvizje gjykatën kushtetuese "në pajtim me këtë kushtetutë". E thënë me fjalë të tjera, si dhe nisur nga fakti i autorësisë së huaj të Kushtetutës, fjalia si më sipër në neni 135.4 që thotë se Avokati i Popullit ka të drejtë të referojë çështje kushtetuese vetëm në pajtim me dispozitat "e kësaj Kushtetuese" domosdo që ka rrënjët në zgjidhjet e jashtme kushtetuese nga ku është marrë. E thënë me fjalë të tjera, cilësimi që i bëhet të drejtës për të ngre çështje kushtetuese në nenin 135.4 të Kushtetutës ka origjinë në përvojat dhe zgjidhjet kushtetuese krahasimore.

Në fund, gjenerata e parë e Gjykatës Kushtetuse ka ardhur deri te një konsensus që të merret opsioni i parë, jo i dyti, që i lejon Presidentit dhe Qeverisë të drejtën për ngritur çështje kushtetuese, krahas atyre që kanë të bëjnë me një rast dhe mosmarrëveshje konkrete kushtetuese në kuptim të nenit 113 (parag. 2 & 3) të Kushtetutës. Ato çështje kushtetuese, siç ka vërejtur Gjykata me të drejtë në këtë rast,[163] mund të jenë të nduarnduarshme, me fillim që nga çështjet që kanë të bëjnë me ushtrimin e kompetencave të organeve kushtetuese, përfshirë vetë Presidentin dhe Qeverinë, ndarjen e pushteteve, ruajtjen e rendit kushtetues, funksionimin e sistemit kushtetuese dhe kështu me radhë. Ikja nga ushtrimi i juridiksionit kushtetues jashtë kontekstit të një rasti dhe mosmarrëveshjeje kushtetuese, në fakt, ka lindur në vijim të luftës për ruajtjen e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Kjo ka ndodhur në **SHBA** dhe do ta vejmë në dukje në vazhdim.

Një defekt tjetër serioz përmbajtësor i argumentit në këtë vendim lidhet me premisën tjetër, të dytën, ku Gjykata thotë se nuk është në natyrën e gjyqësisë kushtetuese të shqiptojë **mendime këshilluese,** përkatësisht të marr rol **konsultativ apo këshilldhënës**. Për më tepër, gjithnjë sipas Gjykatës, edhe në ato vende ku ka pasur një praktikë të tillë, ajo është braktisur pikërisht sepse nuk është në natyrën e gjyqësisë kushtetuese. Si argument për këtë të fundit përmendet **rasti gjerman**.[164] Krejt kjo premisë është fiktive dhe me hamendje, tërësisht e paqëndrueshme dhe atë për dy arsye. Në rend të parë, **mendimet këshilluese** ekzistojnë në gjyqësinë kushtetuese krahasimore si rezultat i përvojës, si p.sh. në **Bullgarinë** e pas **Luftës së Ftohtë**, por edhe si pasojë e zgjidhjeve shprehimore kushtetuese, si p.sh. në një pjesë të vendeve të botës ish-komuniste në **Evropë**, në **Afrikën e Jugut** dhe kështu me radhë, të cilat i diskutojmë më poshtë. Kjo nënkupton se, në ato raste kur **mendimi këshillues** është futur si përvojë, mund të braktiset në po atë po atë mënyrë siç është përqafuar – përmes përvojës së ndryshuar

[162] Këto pikëpamje janë shprehur që në vitin 2013, në komentarin e Kushtetutës së Kosovës: Cf. Enver Hasani & Ivan Cukalovic, *Kushtetuta e Republikës së Kosovës: Komentar*, fq. 400-402 & 444-445.

[163] Paragrafi 71 i Aktvendimit në rastin e **KQZ.**

[164] Paragrafi 76 i Aktvendimit në rastin e **KQZ.**

Sikundër u tha, përqafimi mund jetë rezultat i zgjidhjes kushtetuese dhe ligjore, siç ka ndodhur në **Gjermani**. Në të gjitha rastet, megjithatë, **juridiksioni këshillëdhënës** ka pasur të bëjë me kontrollin preventiv, **ex ante**, të draft-ligjeve, pra me kontrollin e aktivitetit normëvënës të organit përfaqësues, jo me aktivitetin e organeve të tjera kushtetuese, siç ka qenë rasti me praktikën kushtetuese kosovare dhe vendimet e saj të natyrës këshilluese që diskutohen këtu.[165] Në esencë, vetë kontrolli **ex ante** përbën një lloj këshillëdhënie në dobi të ligjvënësit, me një dallim që vendimi ka fuqi detyruese për këtë të fundit. Në rastet kur kjo ka pasur të bëj me normat në fuqi, në fakt, aty fjala ka qenë për shndërrimin e ligjeve në super ligje përmes interpretimit këshillëdhënës ashtu që kjo praktikë është ndërprerë me kohë. E kemi fjalën për **rastin polak** dhe vitet e para të gjyqësisë kushtetues në këtë vend (1989-1997).[166] Në rastin e **Kosovës** asnjëherë nuk ka pasur vendimmarrje të natyrës këshillëdhënëse në sferën e kontrollit të ligjvënies, qoftë **ex ante** apo **ex post**. Në përgjithësi, ky lloj vendimmarrje ka qenë i rrallë edhe në praktikën krahasimore, siç do të shohim në vijim.

Rasti gjerman si më sipër zihet në gojë nga Gjykata në mënyrë të gabuar sepse përvoja gjermane me **vendime këshilluese** nuk është futur përmes përvojës, si në Kosovës, por me anë të një ligji të veçantë. Edhe përvoja me **ankesën kushtetuese** në Gjermani është futur me ligj, jo me **Ligjin Themelor**. Këtu nuk ka asgjë të keqe sepse, fundja, në pjesën dërrmuese juridiksioni i gjykatave kushtetuese mund të caktohet dhe caktohet edhe me ligje organike që normojnë organizimin dhe funksionimin e gjykatave kushtetuese. Në Kosovë, megjithatë, ky nuk është rasti: **Ligji Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese** (**Ligji Nr. 03/L-121**) nuk parashikon asnjë juridiksion shtesë. Një autorizim të tillë e gjejmë vetëm në nenin 113.10 të Kushtetutës së vitit 2008, që thotë se "juridiksioni shtesë mund të rregullohet me ligj". Se për cilat raste bëhet fjalë e kemi sqaruar seksionin **11.3** të kapitullit njëmbëdhjetë që flet për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

Arsyeja e dytë dhe më vendimtare që provon të kundërtën e asaj që thuhet në vendim është se pikërisht vet natyra e gjyqësisë kushtetuese është diçka në mes të mendimit këshillues dhe vendimmarrjes me tipare të gjykimit klasik. Kjo në fakt ka qenë teoria dhe praktika e gjyqësisë kushtetuese si ligjvënie negative, ku gjykata kushtetues nuk bënë anulimin e normës jo kushtetuese por vetëm i jep parlamentit konstatimin e vet mbi jokushtetutshmërinë duke ia lënë një afat për rregullimin e gjendjes së konstatuar jo kushtetuese. Kjo teori dhe praktikë ka pasur të bëj me ligjet dhe normat tjera juridike në fuqi dhe në **Austri** ka qenë i fuqizuar në veçanti në vitet 1925-1929. Kjo natyrë kësisoj e shpërfaqur në fillet e gjyqësisë kushtetuese në djepin ku ka lindur, në **Austri**, ka qenë edhe më e shprehur në rastin çekosllovak në mes dy luftërave botërore. Si e tillë, natyra në fjalë e fsheh esencën e idesë së gjyqësisë kushtetuese si profesion, që në kohën e lindjes së saj, gjë që vërehet edhe nga përmbajtja e debatit tanimë të diskutuar **H. Kelsen** – **K. Shmit**. Nga ky debat mësojmë se gjyqësia kushtetuese ka lindur në vijim të përpjekjeve për të siguruar supremacinë e kushtetutës si akti më i lart juridik në nivel vendi, duke shërbyer si ligjvënës negativ: vetë vendimet e dy gjykatave të para kushtetuese të themeluara pas **Luftës së Parë Botërore**, të **Austrisë** dhe Çekosllovakisë, kanë pasur natyrën e **vendimeve këshilluese** sepse i kanë lënë një hapësirë të caktuar të mjaftueshme organit ligjvënës për të vendosur lidhur me fatin e një ligji objekt kontrolli kushtetues, të deklaruar me vendim si jo në pajtim me kushtetutën nacionale. E thënë me fjalë të tjera, vetë ideja e gjyqësisë kushtetuese në fillim ka konsistuar në atë që vendimet mos të jenë përfundimtare, por të shërbejnë vetëm si një guidë (udhëzues) për parlamentet nacionale për sa i përket cilësisë kushtetuese të ligjeve të shpallura si jo-kushtetuese: shfuqizimi me efekt anulimin e tyre, ndërkaq, ka qenë prerogativë e parlamenteve nacionale. Kjo praktikë është ndjekur në disa gjykata kushtetuese të themeluara pas **Luftës së Dytë Botërore**, përfshirë **Gjykatën Kushtetuese**

[165] Wojciech Sadurski, *Rights Before Courts. A Study of Constitutional Courts in Postcommunist States of Central States of Central and Eastern Europe* (Springer: The Netherlands, 2008) fq. 13, 76-79

[166] Ibid., fq. 12 (kjo praktikë është ndërprerë me arsyetimin se cenon parimin e ndarjes së pushteteve, përkatësisht me faktin se interpretimi i ligjeve është detyrë e gjyqësorit të rregullt, jo e gjyqësisë kushtetuese).

të ish-Jugosllavisë. Reliktet e kësaj qasje fillestare në konceptimin e gjyqësisë kushtetues si profesion hasen edhe në disa gjykata kushtetuese post-komuniste, si p.sh në **Rumani** dhe **Poloni,** vendimet e të cilave në një kohë kanë mund të rrëzohen në organin përfaqësues me një shumicë të caktuar të kualifikuar të votave.[167]

Nga si më sipër, del qartë se ka qenë sfera e kontrollit abstrakt të normës juridike ajo që ka lindur përvojën e **vendimeve këshilluese** të gjykatave kushtetuese në kontinentin evropian. Krahas kontekstit të kontrollit abstrakt të normave juridike, një numër i gjykatave kushtetuese të vendeve ish-komuniste kanë sanksionuar interpretimin e kushtetutës në dobi të organeve qendrore të pushtetit, si një formë juridiksioni jashtë zgjidhjes së një rasti apo mosmarrëveshjeje konkrete (**Bullgaria, Hungaria, Rusia** dhe **Sllovakia**).[168] Ky juridikison në këto vende ka qenë i përcaktuar me kushtetutë, me përjashtim të **Bullgarisë**.

Në të njëjtën kohë me këtë zhvillim është konsoliduar natyra dominante e gjyqësisë kushtetuese, e cila konsiston në vendimmarrjen që ka natyrë të gjykimit klasik meritor me të cilën i jepet fund një rasti apo mosmarrëveshjeje konkrete kushtetuese.[169] Procedura e zgjidhjes dhe vendosjes së një rasti apo mosmarrëveshjeje konkrete kushtetuese me vendim gjyqësor meritor konsiston në interpretim me qëllim zbatimin e kushtetutës nacionale që për synim parësor ka sigurimin e supremacisë (epërsisë) së saj. **Interpretimi bëhet kur rasti dhe mosmarrëveshja kushtetuese kanë për objekt kontrollin kushtetues të normave juridike (kushtetuese, ligjore apo normave të tjera juridike të natyrës së përgjithshme), kurse zbatimi i kushtetutës ndodhë atëherë kur rasti dhe mosmarrëveshja kushtetuese kanë për objekt kontrollin kushtetues të një akti, veprimi apo mosveprimi të një organi shtetëror apo publik, gjithashtu me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së kushtetutës**. E kuptuar në terma juridiksionalë, **pra si tërësi e kompetencave që përbëjnë fizionominë kushtetuese të një organi**, interpretimi dhe zbatimi i kushtetutës hyjnë në kategorinë e juridiksionit kushtetues në kuptimin e plotë të fjalës.[170] Kjo vlen për secilën kompetencë të gjykatave kushtetuese, qoftë kur bëhet fjalë për gjykatat kushtetuese që kanë juridiksion të përcaktuar qartë në kushtetutën nacionale apo për ato që këtë juridiksion e kanë fituar përmes praktikës gjyqësore (d.m.th. si kur bëhet fjalë me gjyqësinë kushtetuese **kelseniane/evropaine**, gjyqësinë kushtetuese **amerikane** dhe gjyqësinë kushtetuese që ka natyrë të **përzier**/**hibride**).

Në anën tjetër të **Atlantikut**, ndërkaq, ka qenë pikërisht arsyeja e mungesës së kontekstit të **rastit dhe mosmarrëveshjes konkrete** ajo që ka çuar në ndalimin e praktikës së vendimeve këshilluese në nivel qendror.[171] Ky ndalim i dhënies së mendimeve këshilluese ka nisur në vitin 1793, kur presidenti i SHBA-ve, **George Washington** (1732-1799), kishte kërkuar nga **Gjykata Supreme** një këshillë lidhur me disa çështje delikate që kishin të bënin me neutralitetin e vendit të tij në luftën në mes të **Britanisë së Madhe**

---

[167] Ibid. fq. fq.13-14 (kjo praktikë është abroguar dhe nuk ekziston më; ka qenë prezente vetëm në vitet e para formative të këtyre dy gjykatave kushtetuese).

[168] Në literaturë, detyrimi i gjykatave kushtetuese për të dhënë interpretime kushtetuese në "të thatë", pa asnjë objekt kontrolli kushtetues kundrejt të cilit do të vlerësoheshin parametrat e kontrollit kushtetues, është cilësuar si një ndër manifestimet më të qarta të natyrës së veçantë këshillëdhënëse të tyre dhe të misionit parësor për dhënien të ndihmës organeve shtetërore në ligjvënie dhe ushtrim të pushtetit shtetëror sipas kushtetutës dhe ligjit. Cf. Herman Schwartz, *The Struggle for Constitutional Justice in Post-Communist Europe* (The University of Chigaco Press: Chicago, 2000) fq. 26, 256 (fusn. 28-31 dhe teksti që i shoqëron).

[169] Në literaturë janë shënuar tri arsye për konsolidimin e gjyqësisë kushtetuese ashtu siç e njohim sot, një trend ky që ka nisur hovshëm pas mbarimit të **Luftës së Dytë Botërore**: zgjidhja e konflikteve për kompetencë (si arsye e parë klasike e lindjes së gjyqësisë kushtetuese), sigurimi i sundimit të ligjit, mbrojtja e të drejtave dhe lirive kushtetuese dhe proceseve demokratike brenda shteteve, përfshirë këtu kontrollin kushtetues të normave juridike dhe, së fundi, anëtarësimi në **Bashkimin Evropian** dhe në **Këshillin e Evropës**, ku gjykatat në **Strasburg** dhe **Luxemburg** luajnë një rol kolosal në formatizimin e shoqërive evropiane sipas standardeve dhe vlerave të konstitutcionalizmit dhe traditës evropiane. Cf. më shumë në Maartije de Visser, *Constitutional Review in Europe. A Comparative Analysis* (HART Publishing: Oxford and Portland, Oregon 2015) fq. 55-78.

[170] Ibid. fq.54-55.

[171] Cf. më shumë për historinë e këtij zhvillimi në shënimin analitik joautorial njëzetfaqësh me titull "Advisory Opinions and the Influence of the Supreme Court over American Policymaking". *Harvard Law Review* Vol. 124 No. 8 (June 2011) fq. 2064-2082.

dhe **Francës**. Gjyqtarët e **Gjykatës Supreme** nën udhëheqjen e kryegjyqtarit **John Jay** (1745-1829) kishin refuzuar të jepnin këshilla lidhur me marrëveshjet ndërkombëtare të **SHBA**-ve dhe çështjen e neutralitetit në kohë lufte, duke u arsyetuar me faktin se nuk bëhej fjalë për një rast apo mosmarrëveshje konkrete që binte në kuadër të kompetencës së tyre dhe, për pasojë, një gjë e tillë binte ndesh me parimin e ndarjes së pushteteve. Në fakt, **George Washington** dhe kabineti i tij kishin dërguar hiç më pak se 29 pyetje politike me të cilat kërkonin nga **Gjykata Supreme** që të prononcohej rreth detyrimeve të **SHBA**-së ndaj palëve ndërluftuese (**Britanisë së Madhe** dhe **Francës**, bazuar në traktatet në fuqi dhe në të drejtën ndërkombëtare.[172]

Defekte të natyrës përmbajtësore shpërfaqen edhe në paragrafët 65[173] dhe 66[174] të **Aktvendimit për KQZ**, të cilat janë tërësisht jokontekstuale dhe pa asnjë lidhshmëri me njëri tjetrin. Gjykata këto dy paragrafë i përdorë në pjesën e vet arsyetuese për të treguar se neni 113 ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] i Kushtetutës natyrshëm pason nenin e saj 112.1 ["Parimet e Përgjithshme"].[175] Me këtë, Gjykata ngatërron definimin e natyrës juridike të Gjykatës Kushtetuese nga neni 112.1 i Kushtetues si "[...] autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën dhe kontrollin e kushtetutshmërisë (jo të ligjshmërisë)", me dispozitat e nenit 113 të Kushtetutës, të cilat pasqyrojnë në formë të operacionalizuar këtë natyrë juridike. E thënë me fjalë të tjera, Gjykata me rastin e vendosjes së këtij rasti ka shpërfaqur mungesë të njohurive themelore lidhur me dallimin në mes të **interpretimit** dhe **kontrollit kushtetues** apo **kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë** në kontekst të zbatimit të kushtetutës përkatëse nacionale. Këtë dallim nuk e bën Kushtetuta dhe nuk e bëjnë as kushtetutat e vendeve të tjera. Ky dallim ka lindur dhe bëhet ekskluzivisht nga praktika e gjyqësisë kushtetuese si profesion relativisht i ri. Në rastin e parë, me **interpretim kushtetues**, nënkuptohet procesi i ndërtimit apo krijimit të kuptimit dhe i sqarimit të kushtetutës nacionale (nëse ekziston si tekst i shkruar), i teksteve të tjera kushtetuese dhe i normave e parimeve të tjera të pashkruara që kanë veçori kushtetuese. Në të dytin rast, ndërkaq, në rastin e kontrollit kushtetues apo të **kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë** bëhet fjalë për një proces në të cilin vlerësohet nëse sjellja e një akteri kushtetues që materializohet në akte juridike apo mosveprimi (ometimi) nga ana e akterit të tillë, që po ashtu materializohet në një gjendje që prodhon pasoja juridike, është në pajtim me kushtetutën, me tekstet tjera apo me parimet që kanë cilësi kushtetuese.[176]

16.11. Rasti i tentim-rrënimit të Gjykatës Speciale

Objekt i procedurës së kontrollit kushtetues në këtë rast ka qenë shqyrtimi i kërkesës së Presidentit të Republikës për vlerësim të konfliktit në mes të kompetencave kushtetuese të Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës, siç është përcaktuar me nenin 113.3 (1) të Kushtetutës.[177] Vetë **petitumi**, ndërkaq, ka pasur të bëj me ekzistimin e një konflikti për kompetencë në mes të **Presidentit të Kosovës** dhe **Kuvendit të Kosovës**, të cilin kërkohej ta zgjidhte me aktgjykim Gjykata

---

172 Herman Schwartz, *The Struggle for Constitutional Justice in Post-Communist Europe*, fq. 256 fusnota nr. 29 dhe teksti që e shoqëron; Për një analizë të detajuar të lindjes së këtij rast, Cf. edhe në "Advisory Opinions and the Influence of the Supreme Court over American Policymaking", fq. 2066-2069.

173 "[…] 65. Në lidhje me këtë, Gjykata rithekson se neni 112 i Kushtetutës përcakton që Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën" **Aktvendimi për KQZ.**

174 "[...] 66. Andaj, ashtu siç specifikohet me të drejtë në përmbajtjen e kërkesës së parashtruesit, Gjykata Kushtetuese, sipas nenit 113, paragrafit 1 të Kushtetutës ka juridiksion të vendosë vetëm për rastet e ngritura para saj në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar." **Aktvendimi për KQZ**

175 "[…] 67. Në këtë kuptim, Gjykata është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës, sipas nenit 112, paragrafit 1 të Kushtetues, në lidhje me rastet e ngritura para saj sikurse përcaktohet me nenin 113. Gjykata nuk merret me interpretime për çështje që lidhen me veprime ose mosveprime juridike të institucioneve kushtetuese për të cilat nuk është e autorizuar sipas nenit 113 të Kushtetutës. Prandaj, neni 112, paragrafi 1, i Kushtetutës nuk mund të interpretohet jashtë kontekstit të nenit 113 të Kushtetutës. […]". **Aktvendimi për KQZ**

176 Maartije de Visser, *Constitutional Review in Europe. A Comparative Analysis*, fq. 2.

177 Paragrafët 2 & 3 ["Objekti i Çështjes"] të **Aktvendimit në rastin e tentim-rrënimit të Gjykatës Speciale.**

Kushtetuese. Këtë, sikundër shihet nga titulli i vendimit, nuk e ka bërë Gjykata, e cila ka vendosur se fjala ka qenë për një rast të palejueshëm. Të shohim si duket brendia e arsyetimit të këtij vendimi dhe vetë historiku i lindjes së tij.

Në këtë rast vlejnë, **mutatis mutandis**, të gjitha ato që janë thënë në rastin e **KQZ**: Gjykata edhe këtu shpërfaq mungesë të dijes profesionale lidhur me konceptet themelore të interpretimit dhe zbatimit të Kushtetutës, si dhe lidhur me dallimin në mes të kontrollit kushtetues (**constitutional reviw**) dhe kontrollit gjyqësor (**judicial review**). Në shtjellimet e veta në këtë rast, Gjykata ka shkuar një hap më tutje në shpërndarjen e mosnjohjes së gjërave themelore rreth kontrollit kushtetues **preventiv (ex ante)** dhe **represiv (ex post),** duke përdorur termat **ex ante** dhe **ex post** në një kontekst tërësisht të pavend dhe që nuk ka asnjë lidhje me **konfliktin për kompetencë.**

Pasi konstaton se nuk ka një definim kushtetues të termit **konflikt për kompetencë,**[178] Gjykata konstaton se këtë herë dhe çdoherë tjetër një definim i tillë i konfliktit pë kompetencë do të varet nga rrethanat e rastit konkret. Sikundër dihet, definimi i konfliktit për kompetencë nuk mund të jetë dhe nuk është çështje e definimit kushtetues sepse, po të ishte ashtu, atëherë gjykatat nuk do të kishin nevojë për të bërë asnjë interpretim të kushtetutës apo të ligjit me të cilin definohet ky koncept. Në praktikën krahasimore, e cila është me bollëk dhe e qasshme, konflikti për kompetencë definohet dhe sqarohet falë praktikës gjyqësore, e cila ka ndërtuar terminologji të mjaftueshme për të përshkruar fenomenin në fjalë kur ai të ndodhë. Në mesin e kësaj terminologjie bëjnë pjesë kuptimet dhe shprehjes siç janë: **konflikt pozitiv për kompetencë** dhe **konflikt negativ për kompetencë**. Numri i palëve në konflikt rreth kompetencave kushtetuese nuk çon asnjë peshë, nisur nga fakti natyra e konfliktit përbën momentin vendimtar definues të këtij koncepti kushtetues dhe ligjor në të drejtën krahasuese.

Të kthehemi sërish aty ku ngelëm, te përdorimi pa vend dhe jashtë kontekstit nga Gjykata i terminologjisë **ex ante** dhe **ex post**, për të shënuar kontrollin preventiv dhe represiv, pa caktuar se çka është objekt i këtij kontrolli preventiv (**ex ante**) dhe represiv (**ex post**).

Në paragrafin nr. 97 të këtij Aktvendimi, Gjykata përdor këto dy koncepte si më sipër duke u bazuar në analogjinë me kontrollin preventiv dhe represiv të normës juridike (**kontrolli abstrakt i normës**), por në fakt mëton të sqaroj **konfliktin negativ** dhe **konfliktin pozitiv për kompetencë.** Një elaborim të tillë nuk e hasim askund në ndonjë libër mbi të drejtën apo gjyqësinë kushtetuese dhe, si i tillë, përbën një fiksion dhe konstrukt lokal pa asnjë vlerë jashtë rastit dhe autorëve që e kanë sajuar. Këtë koncept fiktiv më pastaj, Gjykata provon ta subsumoj (nënvë), në paragrafët 98 & 99 të Aktvendimit, nën kategorinë e konfliktit të interesit ashtu siç përshkruhet jashtëzakonisht qartë në nenet 31 & 32 të **Ligjit nr. 03/L-121** dhe rregullit 68 të **Rregullore së Punës** të Gjykatës (**RP**). As dispozitat e këtyre normave të përgjithshme nuk përmbajnë definicionin e konfliktit për kompetencë, por vetëm saktësojnë elementet që duhet të përmbajë një kërkesë që ka për objekt një petitum që pretendon cenimin e kompetencave kushtetuese të një subjekti kushtetues.

Si rezultat i kësaj përpjekje për subsumim (nënvënie) të një gjendje faktike joekzistuese nën normat kushtetuese, ligjore dhe nën rregullat e brendshme të Gjykatës, në paragrafin 100 të Aktvendimit konstatohet se kërkesa është paraqitur brenda afatit gjashtë (6) mujor, duke e marrë si nisje të afatit 8 qershorin e vitit 2018, ditën kur **Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian** ka pranuar letrën e Presidentit të Republikës për lidhjen e Marrëveshjes Ndërkombëtare për vazhdim të mandatit të misionit **EULEX** edhe për dy vitet në vijim. Nga ky akrobacion fiktiv i Gjykatës qartë del se palë në konflikt është **Presidenti i Kosovës** dhe **Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian** (sic!). Kuvendi i Kosovës nuk shfaqet askund në këtë mes. Të shohim tutje çfarë ndodhë!

[178] Paragrafët 95 & 96 ["Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës"] të **Aktvendimit në rastin e tentim-rrënimit të Gjykatës Speciale**.

Vetëm kur ka kuptuar se logjika e konstrukteve fiktive të situatave të paqena nuk mund të nënvihet (subsumohet) nën normat kushtetuese, ligjore apo nën rregullat e **RP**, Gjykata iu ka kthyer fjalëve çelës që ndërtojnë fjalitë e paragrafëve 2 & 3 të rregullit 68 të **RP**, rregull që operacionalizon deri në detaje dhe i definon me saktësi elementet që përbëjnë kuptimin e **konflikt për kompetencë në çështjet kushtetuese**, si të atij negativ ashtu dhe atij pozitiv. Këto dispozita, megjithatë, nuk definojnë se çfarë është konflikti për kompetencë. Kjo sepse atë duhet ta bëjë vetë Gjykata duke u bazuar në elementet e dispozitave të përgjithshme. Në këtë kontekst, në dy rastet, sipas dy paragrafëve të rregullit 68 të **RP,** kërkohet ekzistimi i një akti juridik që është lëshuar nga një organ kushtetues, me të cilin vihet në konflikt me një organ tjetër kushtetues rreth kompetencave respektive kushtetuese. Ky përshkrim nuk duket se i shkon rastit të përshkruar ne kërkesën e **Presidentit të Republikës** sepse as Kuvendi dhe asnjë organ tjetër kushtetues në **Kosovë** nuk ia kanë cenuar të drejtat e detyrat e tij kushtetuese. Kjo shpjegon faktin se përse asnjë deputet dhe askush nga organet e tjera kushtetuese nuk kanë dhënë asnjë përgjigje ndaj kërkesës së Presidentit për konflikt për kompetenca kushtetuese, kur një gjë e tillë nga ata është kërkuar prej Gjykatës Kushtetuese.

Kjo, megjithatë, nuk është e tëra: **kërkesa për konflikt për kompetencë kushtetuese** nuk përbën **kërkesën origjinale** me të cilën është vënë në lëvizje Gjykata. Në fillim ka qenë një kërkesë krejtësisht tjetër nga ana e Presidentit: kërkesa për konflikt për kompetencë është bërë pas një **ftese** që vetë Gjykata i ka bërë **Presidentit të Republikës** për ta ridefinuar kërkesën fillestare të paraqitur në bazë në nenit 84.9 të Kushtetutës. Në ndërkohë që Gjykata kishte vendosur rastin e **KQZ**, duke e ndërprerë në mënyrë arbitrare dhe jo profesionale një praktikë të saj të mëparshme, më pas, vetë ajo e ka ftuar me letër Presidentin që ta ridefinojë, nëse do, të njëjtën kërkesë sipas parametrave të tjerë juridiksional që lidhen me **konfliktin për kompetencë** kushtetuese nga neni 113. 3 (1) [“Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara”] i Kushtetutës.[179] Ky gjest i Gjykatës është parë si luajtje e rolit të avokatit të Presidentit nga ana e Gjykatës. Kjo, pa asnjë dyshim, përbën një precedent të çuditshëm dhe aspak normal për analet e gjyqësisë kushtetuese kosovare, pse jo edhe një precedent të rrezikshëm.[180]

Nuk është kërkesa rreth konfliktit për kompetencë, megjithatë, ajo që zbulon motivin real të parashtruesit të saj, dhe as vetë sjellja e Gjykatës, por përmbajtja e pyetjeve të kërkesës së parë më të cilën parashtruesi ka kërkuar interpretimin e nenit 18 [“Ratifikimi Marrëveshjeve Ndërkombëtare”] të Kushtetutës. Ajo pyetje, **në kërkesën e vet origjinale** të parashtruar nga Presidenti më datën 4 shtator 2018, ka qenë si vijon:

“[...] Kërkesa e parashtruesit:

62. Parashtruesi i kërkesës, fillimisht, përmes kërkesës së dorëzuar në Gjykatë të bazuar në paragrafin (9) të nenit 84 të Kushtetutës, kërkoi interpretimin e nenit 18 të Kushtetutës, duke pretenduar paqartësi në lidhje me ratifikimin e Shkëmbimit të katërt të Letrave në mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit

179 “[...] 13. Më 3 dhjetor 2018, Gjykata publikoi Aktvendim për Papranueshmëri në rastin K0 79/18, ku parashtrues i kërkesës ishte Presidenti. Në atë rast, Presidenti, në bazë të paragrafit (9) të nenit 84 të Kushtetutës, kishte kërkuar nga Gjykata që të interpretojë paragrafin (4) të nenit 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve] të Kushtetutës. Gjykata e kishte shpallur kërkesën të papranueshme dhe kishte konstatuar se neni 84 (9) nuk është i pavarur prej nenit 113 të Kushtetutës dhe se parashtrimi i çështjeve kushtetuese në Gjykatë duhet të bëhet vetëm mbi bazën e nenit 113 të Kushtetutës.
14. Më 11 dhjetor 2018, Gjykata, duke pasur parasysh faktin që kërkesa K0 131/18 ishte dorëzuar në Gjykatë, para vendimmarrjes së saj në rastin K0 79/18, ku përcaktoi se kërkesat e Presidentit në Gjykatë nuk mund të bazohen vetëm në nenin 84 (9) të Kushtetutës, por janë të ndërlidhura me nenin 113 të saj, kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të sqarojë kërkesën e tij dorëzuar në Gjykatë, duke i dhënë kështu mundësinë që ta sqarojë dhe arsyetojë pranueshmërinë e kërkesës K0 131/18. Gjykata po ashtu e njoftoi parashtruesin e kërkesës lidhur me komentet e dorëzuara nga **Misioni i EULEX**-it si dhe i dërgoi një kopje të tyre. Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që sqarimet e tij lidhur me pranueshmërinë e kërkesës si dhe komentet e tij ndaj komenteve të **EULEX**-it, nëse ka, t’i dorëzoje në Gjykatë deri më 24 dhjetor 2018.
15. Më 24 dhjetor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi sqarimet e tij në Gjykatë, duke ngritur pretendime për **konfliktit të kompetencës kushtetuese** në mes të Presidentit dhe Kuvendit, bazuar në nën-paragrafin (1) të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës lidhur me kompetencat kushtetuese të përcaktuara në nenin 18 të Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës nuk dorëzoi ndonjë koment lidhur me komentet e EULEX-it. […]” **Aktvendimi në rastin e tentim-rrënimit të Gjykatës Speciale.**

180 “Kushtetuta i bën ‘avokatin’ presidentit”. **KOHA DITORE** 15 mars 2019 fq. 1 & 2.

Evropian. Parashtruesi i kërkesës sqaroi se kjo paqartësi ndërlidhej me faktin se: (i) ky ishte Shkëmbimi i katërt i Letrave dhe tri të parat në vitet 2012, 2014, dhe 201 respektivisht, ishin ratifikuar nga Kuvendi përmes ligjeve për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare; dhe (ii) për dallim nga tri rastet e para, Shkëmbimi i katërt i Letrave, redukton kompetencat e **Misionit te EULEX**-it, në kompetenca 'kryesisht' këshillëdhënëse dhe monitoruese.

63. Pas sqarimeve të dorëzuara në Gjykatë më 24 dhjetor 2018, në bazë të kërkesës së kësaj të fundit të 11 nëntorit 2018, parashtruesi i kërkesës deklaroi se kërkesën në fjalë e ka ngritur si çështje të konfliktit të kompetencës kushtetuese në mes të Presidentit dhe Kuvendit, bazuar në nën-paragrafin (1) të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës lidhur me kompetencat kushtetuese të përcaktuara në nenin 18 të Kushtetutës [...]".

Nga kjo qartë del se qëllimi ka qenë për të rrënuar **Gjykatën Speciale**, duke ia hequr bazën juridike për operim në Kosovë, nisur nga fakti se **EULEX**-i, sipas tri letërkëmbimeve të mëhershme, ka fituar si mandat të vetin kryerjen e të gjitha veprimeve që lidhen me **Gjykatën Speciale** (hetime, arrestime, dërgimet në Hagë, mbrojtjen e dëshmitarëve dhe kështu me radhë). Sikur Gjykata të kishte vendosur që kjo Marrëveshje duhet të shkojë për ratifikim në **Kuvendin e Kosovës**, atëherë me siguri se nuk do të merrte dy të tretat e votave të deputetëve dhe, për pasojë, në territorin e Kosovës do të paralizohej në tërësi puna e Gjykatës Speciale. Në të njëjtën kohë, **EULEX**-i, kur është kërkuar të jap përgjigje në kërkesën e Presidentit,[181] nuk ka hezituar t'ua vejë nën hundë gjyqtarëve kushtetues kosovarë faktin e njohur nga çdo jurist mesatar që thotë se misionet e huaja diplomatike dhe personeli i tyre kanë imunitet diplomatik të natyrës absolute, gjë që do të thotë se nuk mund të bëhet fjalë për atë që ata të vihen para gjyqeve vendore në asnjë cilësi. Ky imunitet është dhënë përmes letërkëmbimeve të autoriteteve kosovare me ato evropiane, të cilat paraqesin marrëveshje ndërkombëtare të plotfuqishme.[182]

16.12. Rasti "përsëritja e procedurës"

Siç kemi vënë në dukje më sipër, në hyrje të këtij kapitullit, këtu bëhet fjalë për katër raste të vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese lidhur me çështjen e përsëritjes së procedurës. Këto raste shpërfaqin në mënyrë edhe më të dukshme mosnjohjen nga ana e Gjykatës Kushtetuese të disa aspekteve që kanë të bëjnë me dy çështje për sa vijon:

- e para, mosnjohjen e rolit dhe pozitës së **GJEDNJ** dhe **KEDNJ**, si një traktat ndërkombëtar që përmban zotime të shteteve anëtare për respektimin e të cilave kujdeset vetë **Strasburgu**; [183] dhe
- e dyta, mosnjohjen e marrëdhënies në mes të **GJEDNJ** dhe gjykatave kushtetuese nacionale të vendeve anëtare të saj (ku hyjnë edhe gjykatat e larta nacionale që kryejnë funksionet e gjykatës kushtetuese).

---

181 "[…] 11. Me 12 nëntor 2018, ne cilësinë e palës se interesuar, Gjykata e njoftoi Shefen e **Misionit te EULEX**-it, znj. **Alexandra Papadopoulou**, për regjistrim të kërkesës dhe e ftoi atë që të dorëzojë komentet e EULEX-it, nëse ka, deri me 23 nëntor 2018. 12. Më 23 nëntor 2018, Shefja e **Misionit të EULEX**-it, znj. **Alexandra Papadopoulou**, dorëzoi komentet e saj në Gjykatë." **Aktvendimi në rastin e tentim-rrënimit të Gjykatës Speciale.**

182 " […] Komentet e dorëzuara nga EULEX Kosova:
84. Znj. **Alexandra Papadopoulou**, Shefe e **Misionit të EULEX**-it theksoi se **EULEX**-i nuk mund të shprehë asnjë qëndrim lidhur me kërkesën nën shqyrtim nga Gjykata sepse **EULEX**-i nuk është pjesë e institucioneve të Kosovës, dhe bazuar në imunitetet dhe privilegjet e tyre, nuk mund të jenë palë në procedura në kuadër të juridiksionit të Kosovës.
85. Ajo më tej shtoi se nga perspektiva e Bashkimit Evropian, mandati i **EULEX**-it siç është përcaktuar në Veprimin e Përbashkët të Këshillit, miratuar më 4 shkurt 2008, dhe siç është ndryshuar me vendimet pasuese të Këshillit, dhe bazuar në Shkëmbimin e Letrave të 4 shtatorit 2012, 14 prillit 2014, 9 qershorit 2016 dhe 4 qershorit 2018, përbejnë bazën e Misionit për të vazhduar mbështetjen për institucionet e Kosovës në fushën e sundimit të ligjit.[...]". **Aktvendimi në rastin e tentim-rrënimit të Gjykatës Speciale.**

183 Neni 19 ["Themelimi i Gjykatës"] i **KEDNJ**: "Me qëllim të sigurimit të zbatimit të zotimeve të marra nga palët kontraktuese në Konventë dhe Protokollet e saj, themelohet Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, së cilës këtu i referohemi si 'Gjykata'. Ajo do të funksionojë në baza të përhershme." **European Convention on Human Rights**. Rome: 4. XI. 1959 (with its Protocols, 1, 4, 6, 7, 11, 12, 13, 14 and 16)". Në internet: https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_ENG.pdf (shikuar në janar 2020).

Sa i përket rolit dhe pozitës së **GJEDNJ** në sistemin evropian të drejtësisë, vlen të theksohet se ky institucion ka statusin e një gjykate ndërkombëtare, e cila është themeluar me anë të një traktati, që quhet **KEDNJ**. Funksioni klasik dhe primar i saj ka qenë dhe ngelet ai i mbikëqyrjes së zbatimit të **KEDNJ** dhe zotimeve të marra aty nga ana e shteteve anëtare, kurse me kalimin e kohës ka marrë mbi vete, nga viti 1988, edhe një funksion tjetër – funksionin kushtetues sa i përket lirive dhe të drejtave të njeriut të garantuara me te**.** Ky funksion kushtetues konsiston në vënien e standardeve dhe krijimin e një niveli minimal të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave nga **KEDNJ** në nivel të krejt Evropës. Në literaturë është vërejtur se, në fakt, ky funksion kushtetues ka qenë aty qysh në vitin 1979, kur vetë **GJEDNJ** (që atëherë quhej Komisioni Evropian për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut) kishte vënë në dukje se detyrë e saj nuk ishte vetëm gjykimi dhe vendosja e rasteve të paraqitura pranë saj por edhe të sqaroj, siguroj dhe zhvilloj të drejtat e përcaktuara me **KEDNJ.** [184]

Në ndërkohë që funksioni mbikëqyrës ndaj zbatimit të **KEDNJ** nënkupton vëzhgimin me qëllim të kontrollimit nëse shtetet anëtare po i vejnë në jetë mënyrat dhe masave e duhura që kërkohen nga to për zbatim të dispozitave të saj në rendet e brendshme juridike, funksioni kushtetues nënkupton kujdesin e **GJEDNJ** për krijimin e standardeve mbi të drejtat dhe liritë njerëzore dhe krijimin e nivelit minimal të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të garantuara me **KEDNJ**. Në rastin e parë, të funksionit mbikëqyrës, ajo kujdeset për të parë nëse shtetet nacionale kanë ndërmarrë krejt masat legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore për vënien në jetë të detyrimeve nga Konventa. Në rastin e dytë, në atë të ushtrimit të funksionit kushtetues kundrejt gjykatave nacionale kushtetuese, ndërkaq, ajo ka për detyrë për të parë nëse vendet anëtare të **KEDNJ** janë duke vënë në jetë standardet e njëjta mbi liritë dhe të drejtat e njeriut dhe nëse janë duke ofruar mbrojtjen minimale të lirive dhe të drejtave të njeriut të garantuara me Konventë.

Realizimi i funksionit kushtetues nga **Gjykata në Strasburg** nuk mund të jetë i njëjtë me atë që kryejnë gjykatat nacionale sepse ekzistojnë disa parime dhe doktrina që ajo vetë i ka zhvilluar me qëllim të respektimit të sovranitetit të shteteve palë të **KEDNJ**. Këto parime dhe këto doktrina përbëjnë një kufizim substancial në hapësirën e veprimit të **Gjykatës në Strasburg** kundrejt autoriteteve shtetërore nacionale të shteteve anëtare. Kjo është kështu sepse parimi i barazisë sovrane të shteteve kushtëzon një marrëdhënie shumë specifike në mes të saj dhe autoriteteve kushtetuese nacionale, marrëdhënie që nuk ekziston në mes të gjykatave kushtetuese nacionale dhe gjyqësorit të rregullt dhe organeve të tjera të pushtetit. Ndër parimet kufizuese që dalin si pasojë e barazisë sovrane të shteteve dhe të cilat i ka krijuar dhe zhvilluar **GJEDNJ** në komunikimin e saj me gjykatat kushtetuese dhe autoritetet e tjera nacionale janë: **parimi i subsidiaritetit** dhe **parimi i vlerësimit të lirë** (**margin of appreciation**). Në vitin 2013, me Protokollin nr. 15 në **KEDNJ**, këto dy parime janë kodifikuar dhe përbëjnë një detyrim kontraktues për shtetet anëtare.[185] Me këtë është bërë e qartë dhe është saktësuar hapësira e veprimit të **Gjykatës së Strasburgut** në raport me shtetet anëtare dhe organet e tyre shtetërore.

Parimi i subsidiaritetit është krijuar për të treguar se shtetet anëtare janë në pozitë më të mirë për të vlerësuar kushtet konkrete për vënien në jetë të lirive dhe të drejtave e garantuara me Konventë, kurse në **GJEDNJ** ngelet vetëm roli mbikëqyrës kushtetues për sa i përket vënies në jetë të standardeve minimale të domosdoshme përtej të cilave shtetet palë nuk duhet të shkojnë me rastin e ofrimit të mbrojtjes. Ato mund të ofrojnë më shumë mbrojtje se që është standardi dhe minimumi i ofruar me **KEDNJ**, por jo më pak se aq. Si pasojë e këtij parimi ka lindur parimi tjetër, mbi të cilin mbështetet në fakt parimi i subsidiaritetit dhe njihet si **parimi i lirisë së vlerësimit** (**margin of appreciation**), sipas të cilit shtetet duhet të kenë liri të madhe në vlerësimin e masave dhe hapave që shtetet anëtare duhet t'i ndërmarrin në nivel nacional për të garantuar standardet minimale të parashikuara me **KEDNJ**. Në çështjet ku ka konsensus

---

[184] Janneke Gerards, "The European Court of Human Rights". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* (Cambridge University Press; Camridge, 2017) fq. 237- 276 në fq. 240.

[185] ***Article 1 of the Protocol No. 15 amending the Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental-Freedoms.*** **Council of Europe Treaty Series No. 213. Në internet:** https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/ /conventions/rms/0900001680084831(shikuar në janar 2020).

në nivel evropian, kjo liri vlerësimi është më e ngushtë, kurse në ato ku nuk ka konsensus, si p.sh., në çështjet fetare, në çështjet e të drejtave dhe lirive zgjedhore, të **migracionit** dhe kështu me radhë, kjo liri vlerësimi është shumë më e madhe. Nga kjo del qartë se shtetet anëtare përmes masave të ndërmarra të natyrës legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore vejnë në jetë zotimet e marra me **KEDNJ**, gjë që nënkupton se **GJEDNJ** nuk përcakton liritë dhe të drejtat e njeriut por këtë e bëjnë autoritetet nacionale brenda hapësirës së lënë për veprim nga ana e **KEDNJ.**

Nisur nga kjo gjendje dhe nga kjo pozitë në rendet juridike nacionale të **KEDNJ** dhe të **GJEDNJ**, vendimet e kësaj të fundit në rendet nacionale evropiane nuk kanë fuqi të përgjithshme (**erga omnes**), por vetëm fuqi interpretuese (**res interpretata**) në procesin e vendimmarrjes në nivel nacional sa i përket lirive dhe të drejtave të garantuara me **KEDNJ**. Kjo është kështu sepse natyra juridike e vendimeve të **GJEDNJ** është deklarative ngaqë çdoherë **GJEDNJ** tregon se si duhet të adresohet cenimi i dispozitave të **KEDNJ** nga ana e shteteve anëtare dhe si të ofrohet satisfaksioni për palën viktimë të një cenimi të tillë. Kjo do të thotë se **GJEDNJ** nuk mund të anulojë një ligj apo një masë të ndërmarrë nacionale por vetëm të urdhërojë shtetin cenues të **KEDNJ** që të rikthej gjendjen e mëparshme, nëse ka mundësi, dhe të ndërpresë cenimin e mëtejshëm të **KEDNJ**. Për zbatimin e këtyre vendimeve kujdeset **Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës** (**Komiteti i Ministrave**) por vetëm përmes një presioni politik. Kjo nënkupton se forca reale dhe e vetme e vendimeve të **GJEDNJ** është fuqia interpretuese (**res interpretata**), term që nënkupton se vendimet e **GJEDNJ** janë sqaruese dhe ndriçuese të kuptimeve dhe termave të ndryshme të **KEDNJ**, ashtu siç thuhet në nenin 32 të **KEDNJ,**[186] gjë që rrjedh nga fakti se shtetet anëtare janë zotuar se do të zbatojnë praktikën gjyqësore të **GJEDNJ** kur kjo ka të bëj me to në mënyrë specifike, por edhe në ato raste kur gjetjet e saj kanë të bëjnë me cenime të **KEDNJ** nga ana e shteteve të tjera.[187]

Nga tërë kjo si më sipër mund të nxirren disa përfundime. Në rend *të parë*, roli dhe pozita e **KEDNJ** në hapësirën evropiane është se ajo paraqet një **traktat shumëpalësh ndërkombëtar** me të cilin caktohen disa të drejta dhe detyrime të shteteve anëtare sa i përket kategorive të caktuara të lirive dhe të drejtave të njeriut. Liritë dhe të drejtat e përmbajtura aty, në seksionin e saj të parë, për shtetet palë, kërkohet që të vihen në jetë përmes marrjes së masave të caktuara të natyrës ligjvënëse, ekzekutive dhje gjyqësore nga ana e shteteve anëtare. *Së dyti*, krejt natyrshëm, **GJEDNJ** ka juridiksion për të vendosur dhe gjykuar lidhur me të gjitha rastet që kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e **KEDNJ**. Ky juridiksion, i reflektuar në nenin 32 ["Juridiksioni i Gjykatës"] të **KEDNJ**, është dhënë me qëllim të sigurimit të respektimit nga ana e shteteve anëtare të zotimeve të tyre të marra me rastin e pranimit të **KEDNJ** si pjesë të sistemit të tyre të brendshëm juridik. *Së treti*, nga sa u tha më sipër, internalizimi i dispozitave të **KEDNJ** bëhet përmes teknikave standarde juridike të pranimit të normave ndërkombëtare në rendin e brendshëm të shteteve (ratifikimi, aderimi etj.). Ndër teknikat e pranimit hyn edhe pranimi i njëanshëm i normave ndërkombëtare dhe futja e tyre në rendin e brendshëm përmes teksteve kushtetuese, siç është rasti me **Kosovën** dhe **Bosnje – Hercegovinën**: në dy kushtetutat e këtyre dy vendeve ekzistojnë dispozita të qarta kushtetuese që ia njohin statusin kushtetues **KEDNJ**, kurse interpretimin dhe zbatimin e saj e lidhin me ndjekjen e precedentëve të **GJEDNJ**. Në rastin e Kosovës, kjo sanksionohet në nenet 22 dhe 53 respektivisht të Kushtetutës: neni 22 flet për internalizimin e **KEDNJ**, krahas një sër instrumentesh të tjera dhe dokumentesh ndërkombëtare, ashtu që ato të mund të zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga të gjitha autoritetet publike dhe personat privat në Kosovë, kurse neni 53 flet për fuqinë interpretuese (res interpretatat) të **KEDNJ**. Kjo nënkupton që, jo **KEDNJ**, por praktika gjyqësore e **GJEDNJ** lidhur me

[186] Neni 32 ["Juridiksioni i Gjykatës"] i **KEDNJ**: "Juridiksioni Gjykatës shtrihet ndaj të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e Konventës dhe Protokolleve të saj, ashtu siç përcaktohet me nenet 33,34, 46 dhe 47; 2. Në rast të mosmarrëveshjes lidhur me atë nëse Gjykata ka juridiksion, vendos vetë ajo". **European Convention on Human Rights**. Rome: 4. XI. 1959 (with its Protocols, 1, 4, 6, 7, 11, 12, 13, 14 and 16)". Në internet: https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_ENG.pdf (shikuar në janar 2020).

[187] Janneke Gerards, "The European Court of Huan Rights". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning,* fq. 247-248, 254-259; Rize L. Glas, "The Bundaries to Dialogue with the European Court of Human Rights". Në Wolfgang Benedek, Philip Czech, Lisa Heschl, Karin Lukas and Manfred Nowak (eds.), *European Yearbook on Human Rights*, fq. 287-317.

interpretimin dhe zbatimin e **KEDNJ** përbën burim të së drejtës kushtetuese në Kosovë, si në aspektin material ashtu dhe në atë procedural. Në këtë burim hyjnë edhe doktrinat dhe parimet e sipërcekura lidhur me **subsidiaritetin** dhe **lirinë e vlerësimit** (**margin of appreciation**), të cilat u njihen autoriteteve nacionale në vazhdën e sigurimit nga ana e tyre të lirive dhe të drejtave të garantuara me **KEDNJ**. Ky **subsidiaritet** dhe kjo **liri e vlerësimit** (**margin of appreciation**) sipas redaktimit shprehimor të nenit 1 te Protokollit 15 në **KEDNJ**, ndodhë dhe kryhet çdoherë nën hijen e juridiksionit mbikëqyrës të **GJEDNJ**.

Shikuar nga aspekti i gjykatave nacionale dhe marrëdhënies së tyre me gjykatat e gjyqësorit të rregullt dhe me autoritetet tjera kushtetutshmërinë e të cilave e mbikëqyrin dhe kontrollojnë, subsidiariteti dhe liria e vlerësimit nuk kanë asnjë kuptim dhe nuk gjejnë vend për zbatim. Kjo për shkak se gjykatat kushtetuese në nivel nacional nuk janë në pozitën dhe rolin e **GJEDNJ.** Kjo e fundit, gjykuar sipas rolit dhe pozitës së saj të përcaktuar me **KEDNJ**, është krijuar për të respektuar sovranitetin dhe pavarësinë e shteteve anëtare duke ua caktuar atyre hapësirën minimale brenda së cilës duhet t'i vejnë në jetë dhe t'i implementojnë liritë dhe të drejtat e garantuara me te, gjithnjë duke respektuar standardet dhe substancën minimale të vendosur nga interpretimet e **GJEDNJ**. **Në asnjë rast, gjykata nacionale kushtetuese nuk mund të mbështetet në parimin e subsidiaritetit dhe në lirinë e vlerësimit për të përcaktuar vëllimin dhe cilësinë e lirive dhe të drejtave të garantuara kushtetuese**. Një gjë të tillë nuk mund ta bëj as duke u thirrur në këto dy parime dhe doktrina ashtu siç ato vihen në jetë në nivel evropian nga ana e **GJEDNJ**, për faktin e thjeshtë se gjykatat nacionale kushtetuese nuk janë në pozitën e shteteve anëtare si shtete sovrane dhe të pavarura. Kjo vlen për çdo çështje kushtetuese që shtrohet për vendosje dhe shqyrtim pranë gjykatave nacionale.

Të shohim si duket ky raport në rastet e vendosura që kanë të bëjnë me **përsëritjen e procedurës**. Në këto raste, **Gjykata Kushtetuese** ka theksuar se instituti i **përsëritjes së procedurës** nuk është juridiksion i saj **ratione materiae**. T'i marrim shtruar një nga një këto raste që janë shqyrtuar dhe vendosur nga Gjykata Kushtetuese, si dhe arsyetimet e saj gjoja të bazuara në jurisprudencën e **Gjykatës së Strasburgut**. Ne kemi përzgjedhur këto raste sipas viteve, me randomizim, për qëllime të ilustrimit. Mund të këtë edhe raste të tjera, por këto mjaftojnë për të treguar praktikën gjyqësore të **Gjykatës Kushtetuese** në këtë çështje.

Që në fillim theksojmë se përsëritja e procedurës nuk mund të bie nën juridiksionin e **Gjykatës Kushtetuese** dhe kjo nuk diskutohet. Ajo që diskutohet ka të bëj me atë se si Gjykata ka transformuar arbitrarisht kërkesat e palëve në procedurë për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të tyre kushtetuese në kërkesa për përsëritje të procedurës. Ato të tilla nuk kanë qenë. Të shohim për çfarë bëhet fjalë këtu.

16.12.1. Aspektet problematike të natyrës kushtetuese në vendimet që lidhen me përsëritjen e procedurës

A duhet **Gjykata Kushtetuese** të lidhet me cilësimin juridik të "petitum"-it të parashtruesit të ankesës kushtetuese, apo duhet të ndërtojë mendimin e vet lidhur me juridiksionin duke u mbështetur në mënyrë autonome në fakte objektive, përkatësisht në faktin themelor juridik-kushtetues sipas së cilit objekt i kontrollit kushtetues nga neni 113.7 i Kushtetutës çdoherë paraqitet një akt juridik individual, apo një veprim që prodhon pasoja juridike, i ndërmarrë nga një autoritet publik?[188] Nëse **Gjykata Kushtetuese**, në mënyrë jo kritike substituohet në vend të **Gjykatës së Strasburgut**, duke luajtur rolin e saj në nivel të Kosovës, a mund të ndodhë që abdikimi nga ushtrimi i juridiksionit në rastet e kontrollit kushtetues të vendimeve individuale të autoriteteve publike nga neni 113.7 i Kushtetutës (përfshirë kontrollin kushtetues të veprimeve të tjera individuale që prodhojnë pasoja juridike) përbën cenim të nenit 32 të Kushtetutës, që normon të drejtën për mjete juridike? Kjo për shkak të ekzistimit të parimit civilizues të

[188] Neni 1113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës:
"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

mishëruar në traditat juridike të vendeve perëndimore në dy anët e **Atlantikut**, parimit **non liquet**, sipas së cilit shteti nuk guxon të thotë se nuk ka mekanizma e procedura për të adresuar kërkesat e çdo lloji të qytetarëve dhe subjekteve të tjera të së drejtës, apo se nuk din ta zgjidhë ose vendos rastin konkret. A ka ardhur në këto raste që shtjellohen në këtë seksion deri të cenimi i parimit **non liquet** (mos vendosje si pasojë e paaftësisë apo për shkak të mungesës së mekanizmave e procedurave nacionale për vendosje), gjë që ka për pasojë mohimin e drejtësisë së qytetarëve të Kosovës (**deni de justice**)?

Këto dhe çështjet që lidhen me to i diskutojmë në nënseksionet në vijim, objekt kryesor i të cilave është hulumtimi i disa rasteve individuale të cilat **Gjykata Kushtetuese** i ka cilësuar si "përsëritje e procedurës" me qëllim të konstatimit të mospasjes së juridiksionit lëndor (**ratione materiae**) për vendosjen e tyre. Në nënseksionin e parë në fillim, për lexuesin qartësojmë kuptimin dhe historikun e nenit 53 të Kushtetutës, i cili kërkon nga çdo autoritet publik kosovar që të bazohet në precedentët e **Strasburgut** me rastin e vendosjes për liritë dhe të drejtat kushtetuese të individëve dhe personave juridik. Këtë e bëjmë me qëllim të kontekstualizimit të diskutimit tonë në nënseksionin në vijim, në të cilin prezantohen aspektet kryesore të rasteve që kanë të bëjnë me "përsëritjen e procedurës", përkatësisht me rastet për të cilat Gjykata Kushtetuese ka thënë se nuk ka juridiksion **ratione materiae**.

Në hierarkinë e kompetencave juridiksionale të secilës gjykatë apo organ shtetëror, juridiksioni kushtetues zë vend parësor. Gjithnjë e kemi fjalën për demokracitë kushtetuese të tipit perëndimor, ku bën pjesë Kosova dhe Gjykata Kushtetuese, e cila ka një juridiksion të qartë kushtetues të përcaktuar në nenin 113 të Kushtetutës. Me këtë duam të bëjmë të qartë se vetëm ai juridiksion nga neni 113.7 i Kushtetutës ka shërbyer si parametër për vlerësimin tonë të konstatimeve të Gjykatës Kushtetuese sipas së cilave ajo nuk ka juridiksion **ratione materiae** mbi çështjet që vetë i ka cilësuar si rastet e "përsëritjes së procedurës".

Nënseksioni i dytë në vijim i ofron lexuesit një pasqyrë të përmbledhur të rasteve që deri më sot i ka vendosur **Gjykata Kushtetuese**. Këtu në veçanti fokusohemi në arsyet e dhëna nga vetë Gjykata për mungesën e vetimponuar të juridiksionit **ratione materiae**. Këtë e bëjmë për qëllim të lehtësimit të krahasimit dhe ballafaqimit të argumenteve të përdorura nga **Gjykata Kushtetuese** me ato të dhëna nga **Gjykata e Strasburgut** dhe që vërtetë kanë të bëjnë me përsëritjet e procedurave, si dhe të dallimeve ndërmjet tyre dhe pasojave që prodhon vendimmarrja e tillë e Gjykatës në sferën e lirive dhe të drejtave kushtetuese të kosovarëve dhe individëve të tjerë që përfshihen me juridiksionin e **Kosovës**. Vetë ballafaqimi dhe krahasimi, ndërkaq, ndërmjet vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese dhe precedentëve të Strasburgut, bëhet në nënseksionin e tretë. Kjo i hap rrugë arritjes deri të përfundimet tona lidhur me pyetjet hulumtuese që i ngritëm më sipër në këtë nënseksion.

16.12.2.1. *Raison d' etre* e nenit 53 të Kushtetutës

Në Kushtetutë ekziston një dispozitë shumë specifike, në fakt e tillë si kjo gjendet vetëm edhe në **Bosnje-Hercegovinë**, që në mënyrë shprehimore autorizon autoritetet publike që të marrin si parametër vendosjeje precedentët e **Gjykatës së Strasburgut** çdo herë kur vendosin për liritë dhe të drejtat e individëve dhe të personave juridikë. E kemi fjalën për nenin e sipërcekur 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, i cili thotë si vijon:

"Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut."

Në kohën e globalizimit, përdorimi i materialeve të huaja juridike (vendimet gjyqësore dhe tekstet juridike, qoftë nacionale apo ndërkombëtare) shpesh herë ka fuqi normative, jo vetëm fuqi kognitive siç ka qenë një kohë. Kjo do të thotë se materialet e huaja juridike, në veçanti praktikat gjyqësore, jo vetëm që shërbejnë si material për t'u njohur nga ana e gjyqtarëve vendorë, por edhe si detyrim normativ që duhet vënë *në jetë me rastin e zgjidhjes së rasteve dhe mosmarrëveshjeve të caktuara të natyrës kushtetuese. Kjo rrallë bëhet me nen të veçantë, siç është ky nen si më sipër në* **Kosovë**. Përveç Kosovës, **Bosnje-Hercegovina** ka një dispozitë të tillë shprehimore, e cila detyron organet vendore për të vendosur sipas

precedentëve të **Strasburgut**. Vendet e tjera ndërkaq, në veçanti ato ish-komuniste, këtë forcë normative të precedentëve në fjalë e thithin kryesisht përmes ratifikimit si një detyrim ndërkombëtar. Kjo, me fjalë të tjera, bëhet sikur me çdo detyrim tjetër ndërkombëtar përmes së cilit një shtet zotohet për të vënë në jetë një praktikë të caktuar gjyqësore dhe parametrat e saj të vlerësimit kushtetues të akteve juridike, qoftë individuale apo të përgjithshme, të autoriteteve nacionale publike. Kjo ka qenë në veçanti situata me shumicën e vendeve evropiane ish-komuniste me rastin pranimit të tyre në **BE**. Kur janë pranuar, shtetet në fjalë kanë përqafuar në formë të zotimit ndërkombëtar precedentët e Konventës si standarde që Strasburgu i ka ndërtuar përmes interpretimit të këtij instrumenti.

Siç e pamë më lart, ky megjithatë, nuk ka qenë rasti me Kosovën, e cila sot e kësaj dite nuk është anëtare e **Këshillit të Evropës** (**KE**) dhe, për pasojë, as e **Gjykatës së Strasburgut**. Këtë zotim ndërkombëtar, **Kosova** e ka marrë në mënyrë të njëanshme përmes nenit 53 si më sipër, por edhe përmes nenit 22 të Kushtetutës, që thotë se një numër i caktuar instrumentesh dhe dokumentesh ndërkombëtare kanë zbatim të drejtpërdrejtë, u mor vesh, gjithnjë me supozimin se ngërthejnë norma të vetëzbatueshme.[189] Kjo qasje lidhet me specifikat e kushtetutëbërjes në Kosovë: sikundër dihet, shpallja e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 erdhi si rezultat i një plani të detajuar të bashkësisë ndërkombëtare, **Plani Ahtisari**. Kosova duhej të rrinte nën mbikëqyrjen e bashkësisë ndërkombëtare,[190] *të hartonte një kushtetutë,*[191] ku normat e Planit do të kishin epërsi të përkohshme dhe jo Kushtetuta e vendit,[192] si dhe të ndërtonte organe të pushtetit që në tërësi do të reflektonin demokracinë kushtetuese të tipit **konsociacional**.[193]

Krahas ndarjes së pushteteve, sundimit të ligjit, respektit për të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të bashkësive etnike, gjyqësia kushtetuese përbënte një risi që Shteti i Kosovës kishte marrë zotim se do ta vinte në jetë ditën që kishte shpallur pavarësinë. Kjo gjyqësi kushtetuese, ashtu siç ishte skicuar në **Planin Ahtisari**, do të mbështetej në tërësi në precedentët e Gjykatës së Strasburgut kur behej fjalë për liritë dhe të drejtat e njeriut. Tërë këto zotime u bartën në **Kushtetutën e Kosovës**, miratuar më 15 prill 2008 (hyrë në fuqi më 15 qershor 2008), thuajse **ad literam**. Në këto bartje hyjnë: zotimi nga neni 22 i Kushtetutës, i cili në **Planin Ahtisari** figuronte në nenin 2.1 të Aneksit I [Dispozitat Kushtetuese], nen që bën fjalë për promovimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut; zotimi për garantimin e të drejtës për ankesë kushtetuese nga neni 113.7 i Kushtetutës, i cili në **Planin Ahtisari** gjendej në nenin 2.4 të Aneksit I [Dispozitat Kushtetuese], që po ashtu ka të bëjë me dispozitat mbi promovimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut. Ky korpus i lirive dhe të drejtave të njeriut, sipas nenit 2 që rregullon parimet

---

189 Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] i Kushtetutës:
"Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:
(1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
(2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
(3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;
(4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
(5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
(6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
(7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
(8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese."

190 Neni 1. 10 [Dispozitat e Përgjithshme] dhe Aneksi IX, X & XI të Planit.

191 Neni 1.3 [Dispozitat e Përgjithshme] me Aneksin I të Planit.

192 Neni 143 [Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës] i Kushtetutës (i fshirë me amendamentin nr. 4, botuar në *Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës* nr. 25 datë 7 shtator 2012.)

193 Neni 1 [Dispozita e Përgjithshme] i Planit (në dhjetë paragrafë të këtij neni jepen konturat themelore të **demokracisë konsociacionale** kosovare, ku liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të bashkësive etnike që janë në pakicë zënë vend kryesor); Për shtjellimet e para teorike të këtij lloji të demokracisë në kontekstin kosovar, shih më shumë në: Dren Doli dhe Fisnik Korenica, "The Consociational System of Democracy in Kosovo: Questioning Ethnic Minorities' Special Status in Kosovo's Constitutional Regime" *International Journal of Public Administration* Vol. 36 No. 9 (2013) fq. 601–613. Për shtjellimin e fundit nga studiuesit kosovarë, cf. Adem Beha, "Consociational Democracy and Political Engineering in Postwar Kosovo". *Nationalities Papers* Vol. Vol. 47 Issue 4 (July 2019) fq. 674-689.

e përgjithshme të Planit, duhej të interpretohej nga të gjitha autoritetet kosovare duke marrë parasysh standardet më të larta ndërkombëtare mbi promovimin, respektimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave njerëzore, përfshira këtu ato të vëna në Konventë.[194] *Këto zotime të Planit janë pasqyruar në tërësi në nenet 22, 53 dhe 113.7 të Kushtetutës.*

Kjo praktikë e këtij lloji të dizajnit kushtetues, në literaturë thuhet se është rezultat i ndikimit të trendeve të globalizmit në planin ndërkombëtar, si dhe forcimit të rolit dhe ndikimit të së drejtës ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut në rendet e brendshme të shteteve sovrane. Në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut, një gjë e tillë zakonisht shprehet në formulimin sipas të cilit shteti përkatës do të respektojë dhe sigurojë standardet më të larta ndërkombëtare në këtë fushë.[195]

Bartja e pjesës dërrmuese e dispozitave të **Planit Ahtisari** në **Kushtetutë** ka ardhur si pasojë e rolit dhe pozitës vendimtare të faktorit ndërkombëtar, në rend të parë **BE** dhe **SHBA**-ve, në procesin e kushtetutëbërjes në Kosovë. Në literaturë, kjo është cilësuar si ushtrim i pushtetit origjinar kushtetutëbërës të ndërkombëtarizuar, diçka ngjashëm siç ka ndodhur me gjermanët, japonezët, italianët dhe kombe të tjera të rrënuara nga **Lufta e Dytë Botërore**. Në rastet e fundit, megjithatë, kushtetutëbërja në tërësi ka qenë e imponuar nga faktori ndërkombëtar. Ushtrimi i **pouvoir constituant** ka qenë vepër e tërësishme e aktorëve ndërkombëtarë, shteteve fituese të Luftës së Dytë Botërore. Në rastin e Kosovës kjo nuk ka qenë kështu. Ushtrimi i **pouvoir constituant**, i kushtetutëbërjes kosovare, konsiston në ndarjen e vullnetit nacional me këta aktorë. E thënë ndryshe, aktorët ndërkombëtarë *në Kosovë paraqiten si hisedar*ë *të vullnetit konstituiv të vendit, në ndërkohë që në rastin e* **Japonisë**, **Gjermanisë** dhe **Italisë** ky pushtet kushtetutëbërës është ushtruar në tërësi nga aktorët e jashtëm.[196]

Pikërisht kjo histori e kushtetutëbërjes, e cila ka prodhuar dispozitën e nenit 53 të Kushtetutës, dy gjëra i bën të qarta: e para, se precedentët gjyqësorë të Strasburgut janë materiale të huaja juridike që nuk kanë vetëm vlera kognitive që **Gjykata Kushtetuese** mund t'i përdorë si material për ushtrim intelektual sipas tekeve të momentit; dhe, e dyta, se këta precedentë, si materiale të huaja juridike, shërbejnë si një burim formal i së drejtës, i detyrueshëm fund e krye, të cilin **Gjykata Kushtetuese** duhet ta përdorë siç përdor çdo parametër tjetër kushtetues me rastin e vendosjes së rasteve dhe mosmarrëveshjeve kushtetuese. Kjo nënkupton se, si burim i së drejtës kushtetuese, precedentët e Strasburgut nuk mund të përdoren në mënyrë kognitive, përkatësisht vetëm duke i cituar për qëllime të njohjes. Jo vetëm kaq, ato nuk mund të përdoren duke u vënë në pozitën e **Gjykatës së Strasburgut**, e cila interpreton Konventën dhe zotimet e shteteve anëtare në të kundrejt standardeve minimale evropiane mbi liritë dhe të drejtat njerëzore. Po të lejohej që **Gjykata Kushtetuese** *të zinte vendin e Gjykatës së Strasburgut, atëher*ë do të ndryshonte edhe cilësimi i saj si gjykatë nacionale dhe do të merrte veçoritë e një gjykate nacionale me karakter ndërkombëtar. Këtë nuk e nënkupton mesazhi i dispozitës së nenit 53 i Kushtetutës: krejt çfarë përçon ai mesazh është se vendimmarrja e **Gjykatës Kushtetuese** duhet të jetë në harmoni me precedentët e **Gjykatës së Strasburgut** dhe standardeve minimale që Strasburgu i vë për secilën liri dhe të drejtë të garantuar nga Konventa. Përveç kësaj, kjo nënkupton se si burim formal i së drejtës, këta precedentë duhet të analizohen, si në aspektin e tyre faktik ashtu edhe në atë juridik, para se të bëhet zbatimi tyre në një rast konkret

---

194 Neni 1.2 [Dispozitat e Përgjithshme] i Planit:
"Ushtrimi i autoritetit publik në Kosovë do të bazohet në barazinë e të gjithë qytetarëve dhe respektimin e nivelit më të lartë të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ndërkombëtarisht të pranuara, si dhe në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe pjesëmarrjes së të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre."

195 Gábor Halmai, *Perspectives on Global Constitutionalism. The Use of Foreign and International Law* (Eleven International Publishing: The Hague, 2014) fq. 29-32.

196 Për këtë dallim, cf. më shumë në Ibid., fq. 22-29; Për konceptin e pushtetit kushtetutëbërës të ndërkmbëtarizuar, cf. më shumë në Emily Hay, "International (ized) Constitutions and Peacebuilding". *Leiden Journal of International Law* Vol. 27 No. 01 (2014): fq. 141 – 168 (autori, duke analizuar nga aspekti komparativ rastet e Kosovës dhe të Irakut, vjen në përfundimin se **kushtetutat e ndërkombëtarizuara** gjatë historisë kanë potencial për të qenë legjitime dhe jolegjitime, në vartësi të rrethanave të secilit vend dhe kontekstit historik; autori në mënyrë të shkëlqyer konstaton, duke sqaruar pse-në, se **kushtetutat e ndërkombëtarizuara** sfidojnë rëndë konceptet themelore tradicionale mbi sovranitetin, vetëvendosjen dhe kushtetutën dhe rolin e funksionin e saj në një shoqëri të organizuar në shtet).

apo mosmarrëveshje kushtetuese. Kjo pra, në thelb përbën një proces silogjizmi krejt të njëjtë me atë që bëhet me rastin e interpretimit për qëllime zbatimi të burimeve të tjera formale të së drejtës kushtetuese, që nga Kushtetuta si parametri themelor e deri te parametrat e tjerë.

Kjo si më sipër ka të bëjë me kuadrin referencial normativ për vendimmarrje të Gjykatës Kushtetuese. Në kontekstin e nenit 53 të Kushtetutës nuk shtrohet çështja nëse jurisprudenca e **Gjykatës së Strasburgut** është operacionale në territorin e Kosovës, por se cilat standarde dhe cilat elemente të precedentëve konkretë *të* **Strasburgut** duhet t'i marrin për bazë autoritetet publike, përfshirë **Gjykatën Kushtetuese**, me rastin e interpretimit të tyre me qellim zbatimi si parametra kushtetues të një rasti apo mosmarrëveshjeje konkrete. Kjo është shumë e qartë kur bëhet fjalë për vendet që janë palë në **KEDNJ**: në këto raste, si detyrim për zbatim, me fuqi precedenti, shërbejnë vetëm **aktgjykimet meritore** *të Gjykatës në Strasburg, jo edhe vendimet tjera të dhëna në vijim të shqyrtimit dhe vendosjes së një rasti ku shteti palë është përgjegjës (palë e paditur). Sikundër do të shihet në vijim, shtetet palë, në vijim të zbatimit të këtyre vendimeve, kanë një liri veprimi për të normuar me legjislacionin e tyre të brendshëm mënyrën e vënies në jetë, krahas asaj që përcaktohet me vendim të* **GJEDNJ** dhe standardeve të saj për mënyrën e zbatimit të vendimeve meritore. Sa i përket vendimeve meritore që nuk kanë të bëjnë me shtete palë në **KEDNJ**, ndërkaq, nuk shtrohet fare çështja e vënies së tyre në jetë. Këto vende kanë detyrim kontraktual vetëm sa i përket vënies në jetë të **standardeve minimale** *të mishëruara në* **KEDNJ**, ashtu siç janë interpretuar ato nga ana e **Gjykatës në Strasburg**.[197] Sikundër shihet, as në rastin e parë e as në të dytin, nuk bëhet fjalë për substituimin (zëvendësim) të një shteti palë në Konventë në vend të **Gjykatës në Starsburg**. Po ashtu nuk bëhet fjalë për vendimeve jo meritore të Gjykatës në Strasburg. Dy këto aspekte nuk i ka pasur parasysh Gjykata Kushtetuese kur ka vendosur rastet që diskutohen në këtë seksion, duke u substituar (zëvendësuar) në vend të **GJEDNJ** dhe duke përdorur si precedentë për refuzim të kërkesave edhe vendimet **jo meritore**, të cilat aspak, siç do të shihet në vijim, nuk kanë pasur të bëjnë me raste të ngjashme me origjinë nga Strasburgu me ato të vendosura nga ajo.

Precedentët e Strasburgut, përmes nenit 53 të Kushtetutës janë shndërruar në pjesë përbërëse të së drejtës kushtetuese kosovare, diçka jo shumë e natyrshme për një vend që i takon sistemit juridik kontinental të së drejtës, siç është Kosova. Në ketë sistem, premisa themelore e kuadrit juridik për vendimmarrje të gjyqtarëve është se e drejta paraqet një sistem objektiv kurse gjyqtarët kanë për detyrë të gjejnë këtë të drejtë objektive që gjendet diku atje, objektivisht e dhënë dhe jashtë vullnetit të gjyqtarit që vendos rastin. Ky zbulim i së drejtës në këtë sistem bëhet me qellim të zbatimit të saj në një rast apo mosmarrëveshje konkrete. Në një kohë, pas **Revolucionit Francez**, kjo ka nënkuptuar zhveshjen e tërësishme të gjyqtarit nga çdo subjektivitet, duke parë gjyqtarët janë asgjë pos një **bouche de la loi**. Kjo vinte si pasojë e kompromet-imit të gjyqtarëve si shërbëtorë të **ancien régime**. Sipas këtij botëkuptimi të sistemit kontinental, zbatimi i të drejtës së huaj nuk ka vend. Këto janë vijat e përgjithshme të një tipi ideal të sistemit kontinental.

Ky sistem është i kundërt me sistemin e të drejtës së përgjithshme, në veçanti atë që kultivohet në **SHBA**. Në këtë vend, gjyqtarët jo vetëm që janë subjekte të së drejtës dhe pjesë përbërëse e saj, por shpesh vendimmarrjen e zhvendosin nga sfera juridike në atë politike. Kjo nënkupton që, në ketë sistem, gjyqtari ka hapësirë veprimi dhe vendosjeje në një rast konkret që kufizohet me kriteret politike, gjë që do të thotë se kuptimin juridik të normave e përcakton gjyqtari me rastin e vendosjes për një rast apo mosmarrëveshje.[198] Edhe kjo që u tha përbën vijat e përgjithshme të një forme të pastër të sistemit të së drejtës së përgjithshme.

---

[197] Rize L. Glas, "The Bundaries to Dialogue with the European Court of Human Rights". Në Wolfgang Benedek, Philip Czech, Lisa Heschl, Karin Lukas and Manfred Nowak (eds.), *European Yearbook on Human Rights*, fq. 287-317.

[198] John Dewey, *Logical Method and Law*, *Cornell Law Review* Vol. Issue 1 (1924) fq. 17- 27 (autori diskuton **silogjizmin gjyqësor** që bazohet në rregullat dhe parimet e përgjithshme duke shtuar se logjika bazohet në empirizëm ashtu që silogjizmi mekanik nuk shërben për asgjë dhe bëhet pengesë e proceseve shoqërore. Duke u bazuar në kalimin nga feudalizmi në liberalizëm borgjez, autori thekson se precedentët e kaluar dhe rregullat që kishin krijuar, më pas u bën pengesë e zhvillimit social; në fund, pledoaje e tij është që silogjizmi bazohet në rezultat përfundimtar dhe nuk ka asgjë të bëjë me mënyrën se si operon mendimi i gjyqtarit: ka rendësi që mendimi analitik të dominojë, jo ai mekanik që mbështet në **silogjizëm të ngurtë**).

Dallimi në mes të dy sistemeve si më sipër gjendet te baza mbi të cilën është themeluar dhe qëndron sistemi shoqëror dhe juridik-kushtetues i secilit prej tyre.[199] *Në sistemin e parë, një bazë e tillë gjendet në të drejtën e shkruar dhe të kodifikuar, kurse në të dytin edhe në të drejtën e pashkruar dhe në precedentët nga e kaluara.* **Kosova** hyn në vendet që kanë kombinuar këto dy aspekte kur bëhet fjalë për liritë dhe të drejtat e njeriut, gjë që është sanksionuar në nenin 53 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, **Kosova** nuk është e vetme sepse një situatë të tillë e ndeshim edhe te vendet tjera ish-komuniste, ani se mënyra e internalizimit të së drejtës së huaj ndryshon.

Kjo si më sipër, megjithatë, nuk do të thotë se gjyqtarët kushtetues në **Kosovë**, si dhe gjyqtarët e vendimmarrësit e tjerë publikë, mund të përdorin në mënyrë liberale dhe krejtësisht për qëllime kognitive, pa i analizuar në thellësi, precedentët e **Strasburgut**. Kjo sepse një gjë e tillë nuk përbën zbatim të nenit 53 të Kushtetutës por shpërdorim i autorizimit të dhënë kushtetues. Këta precedentë duhet të përdoren në atë mënyrë që me saktësi të ndodhë barazimi apo nënvënia (subsumimi) maksimale e anës faktike dhe juridike e secilit rast apo mosmarrëveshje që shqyrtohet dhe vendoset në **Gjykatën Kushtetuese** sipas nenit 113.7 të Kushtetutës me precedentët e prodhuar në Strasburg. Kjo tutje nënkupton se precedentët si burime të së drejtës nuk mund të përdoren për qëllime kognitive, duke cituar sa për sy e faqe një ose disa syresh. Arsyeja e thjeshtë pse kjo është kështu gjendet në faktin se precedentët e **Strasburgut** në Kosovë kanë fuqi të pastër normative me efekt të përgjithshëm për të gjitha autoritetet publike në Kosovë. Ata shërbejnë, me fjalë të tjera, për çdo autoritet publik kosovar, përfshirë **Gjykatën Kushtetuese**, si premisë e sipërme (**premisa major**) për çdo vendimmarrje konkrete në vijim të zbatimit të nenit 113.7 të Kushtetutës. Ky silogjizëm nuk është statik, por thellësisht analitik. Këtu bëhet fjalë për përdorimin e precedentëve në tërësinë e tyre, duke i përdorur ata si bazë faktike dhe juridike, si parametër kushtetues, për vendosjen e një rasti dhe mosmarrëveshje kushtetuese sipas nenit 113.7 të Kushtetutës. Ky nen, sikundër shihet nga redaktimi i tij, qartë sanksionon ankesën e plotë kushtetuese e cila, si standard, fuqishëm rekomandohet nga **Komisioni i Venecias**. Ky rekomandim i futjes së ankesës së plotë kushtetuese kundër akteve individuale të autoriteteve publike bëhet për dy arsye: e para, sepse vetëm **ankesa e plotë kushtetues**e ofron mbrojte të gjithëmbarshme të lirive dhe të drejtave të njeriut; dhe e dyta, sepse juridiksioni i **Gjykatës së Strasburgut** ka **natyrë subsidiare**, që do të thotë se rastet e cenimeve të lirive dhe të drejtave të njeriut duhet të zgjidhen në nivel nacional.[200]

Kjo si më sipër nuk ka qenë rasti me katër vendimet që shtjellohen këtu. Që nga rasti i parë i aktvendimit për papranueshmëri të **Gjykatës Kushtetuese**, precedentët e Strasburgut janë përdorur në mënyrë ngurtë dhe statike, pa iu referuar asnjë paragrafi të tyre të vetëm dhe pa treguar se si këta precedentë pajtohen me katër rastet e vendosura (**sic**!). **Gjykata e Strasburgut** ndërkaq, në secilin rast që e merr si precedent për vendosje tregon se si ana faktike dhe ajo juridike përshtaten me rastin që gjendet pranë saj për shqyrtim dhe vendosje. Të shohim si duket kjo në seksionet në vijim.

16.12.2.2. Katër rastet e vendosura nga Gjykata Kushtetuese

Në këtë seksion lexuesit i ofrohet përshkrimi sa më besnik i pikave kryesore të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, lidhur me rastet që vetë ajo i ka cilësuar si rastet e "përsëritjes së procedurës", ani pse të tilla nuk janë meqë objekt i kontrollit kushtetues në të gjitha rastet nga neni 113.7 i Kushtetutës janë vendimet individuale të gjykatave të rregullta të Kosovës, respektivisht të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatës së Apelit. Bazuar në cilësimin juridik të parashtruesve të ankesave kushtetuese, Gjykata këto raste i ka futur në kategorinë e rasteve kushtetuese ndaj të cilave nuk gjenë zbatim neni 6.1 i **KEDNJ** dhe, për pasojë, ka ardhur deri te konstatimi se në Kosovë nuk ekziston juridiksion lëndor për këto lloje të rasteve (juridiksioni **ratione materiae**).

---

[199] Siniša Rodin, "Constitutional Relevance of Foreign Court Decisions". *The American Journal of Comparative Law*, Volume 64, Issue 4 (December 2016) fq. 815–840 në fq. 819.

[200] European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Compilation of Venice Commission Opinions, Reports and Studies on Constitutional Justice (Updated).* **Strasbourg**, 18 December 2017. CDL – PI (2017) 08. Or. English. Paragrafët: 5.2 & 5.2.1.

Sa i përket strukturës argumentuese, katër vendimet që analizohen këtu përmbajnë argumente që kanë natyrën e argumenteve kushtetuese me një rresht, argumente që janë përfundimtare kundrejt fakteve kushtetuese që mëtojnë t'i provojnë. Kjo strukturë njihet ndryshe si struktura argumentuese **rrathët lidhës zinxhiror** dhe e dominon narrativin e katër vendimeve. Struktura argumentuese si kjo karakterizohet nga ekzistimi i një sërë premisash dhe përfundimesh të ndërvarura, që kanë strukturë lineare argumentuese dhe së bashku formojnë një argument në vetvete, të përdorshëm në mënyrë të pavarur dhe lineare deri në arritjen e verdiktit (përfundimit) lidhur me objektin e çështjes. Kjo strukturë argumentative e vendimeve është më e qarta.

Në ndërkohë që **struktura lineare argumentuese** e përshkruar si më sipër i shkon natyrës së aktvendimit, nisur nga fakti se kjo strukturë e dominon shumicën e arsyetimeve në vendimet jomeritore në gjyqësinë kushtetuese krahasimore, kjo nuk është kështu sa i përket arsyetimeve të **Gjykatës Kushtetuese** lidhur me papranueshmërinë e këtyre katër rasteve. Në këto vendime shpërfaqen defekte që kanë të bëjnë me përmbajtjen e arsyetimit, i cili, në thelb, është i njëjtë në të katër vendimet. Premisa themelore e argumentit të Gjykatës konsiston në faktin që neni 6 i Konventës nuk gjen zbatim në rastet që ajo vetë i ka cilësuar si "përsëritje të procedurës". Mbi bazën e kësaj premise, Gjykata ka arritur në përfundimin e njëjtë në katër rastet: në çështjet që kanë të bëjnë me "përsëritjen e procedurës" nuk zbatohet neni 31 i Kushtetutës, sepse kështu mendohet se ka thënë **Gjykata e Strasburgut**, ani se kërkesat e palëve për përsëritje të procedurës janë bërë pranë gjykatave të rregullta të Kosovës, si gjykata me juridiksion të përgjithshëm jo kushtetues.

Përveç kësaj, strukturës si më sipër argumentuese me formë lineare, në jurisprudencën krahasuese, sipas hulumtimeve, janë vërejtur edhe dy lloje të tjera strukturave të argumentativave kushtetuese që përdoren në arsyetimet e vendimmarrjeve në gjyqësinë kushtetuese.[201] Ato janë:

- struktura e argumenteve kushtetuese me shumë argumente paralele (që përdor strukturë argumentuese kumulative, brenda së cilës pikëpamjet e ndryshme kanë fuqi autonome por që shpijnë në të njëjtin përfundim), e njohur ndryshe si **argumenti këmbët e karriges**; këtu ekzistojnë disa konsiderata të vetëmjaftueshme që pak a shumë shpijnë deri te përfundimi i njëjtë; dhe
- struktura e argumenteve kushtetuese me argumente të përdorura paralelisht, të cilat, megjithatë, individualisht nuk i provojnë në mënyrë përfundimtare faktet kushtetuese, përveç nëse merren në shqyrtim të gjitha së bashku; ky njihet ndryshe si **argumenti me strukturë dialoguese.** N*ë* këtë strukturë parashtrohen dhe mbar*ë*shtohen konsiderata të ndryshme, të cilat në vendim prezantohen si diçka që nuk janë as të domosdoshme dhe as të nevojshme për të nxjerrë një konkluzion përfundimtar por vetëm si elemente treguese me rëndësi për zgjidhjen e rastit apo mosmarrëveshjes kushtetuese.

Kjo renditje e këtyre tri llojeve të strukturës së argumentit kushtetues është bërë në bazë të qartësisë së tyre kundrejt njëri-tjetrit: **struktura e argumenteve kushtetuese me një rresht** që ka natyrë përfundimtare (që e mbyll argumentin e parashtruar me qëllim të vërtetimit të fakteve kushtetuese), i njohur ndryshe si **rrathët lidhës zinxhirorë**, është struktura më e qartë ndër të triat, kurse më e paqarta dhe më e *ç*oroditura është **struktura e argumenteve kushtetuese me argumente të përdorura paralelisht**, të cilat, megjithatë, individualisht nuk i provojnë në mënyrë përfundimtare faktet kushtetuese, përveç nëse merren në shqyrtim së bashku. Kjo strukturë, siç u tha më sipër, njihet ndryshe si **argumenti me strukturë dialoguese.** Në modelin kelsenian të gjyqësisë kushtetuese, megjithatë, në të shumtën e rasteve dominon **struktura e argumentit këmbët e karriges**.

---

[201] Hulumtimi më gjithëpërfshirës deri më sot lidhur me arsyetimin kushtetues, strukturën dhe llojet e argumenteve kushtetuese të përdorura gjendet në librin Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* (cf. fusnota **nr. 171**, **supra**, në këtë kapitull). Ky libër, një rezultat i punës ekipore disa vjeçare të gjyqtarëve kushtetues dhe akademikëve nga lëmi i së drejtës dhe gjyqësisë kushtetuese të botës juridike perëndimore, bazohet në hulumtimet e thella me kombinim të metodologjisë kualitative dhe kuantitative të analizës së vendimmarrjeve, strukturës, formës, stilit dhe gjuhës së përdorur për arsyetim të argumenteve kushtetuese. Këto tri lloje të strukturave të argumentit kushtetues i kemi nxjerrë nga pyetësori i këtij hulumtimi, i cili gjendet në faqet 798-820 të librit, me titull "shtojca". Për këtë lloje të argumentimit në gjyqësinë kushtetuese kemi bërë fjalë gjerësisht në seksionin **15.3** të kapitullit të pesëmbëdhjetë.

16.12.2.3. Rasti parë: *Rasti KI 159/15*

Paragrafët kryesore të këtij vendimi, të cilat ngërthejnë precedentin e parë për çështjet që cilësohen si "përsëritja e procedurës", ku nuk vlen zbatimi 6.1 i Konventës, janë për sa vijon.[202]

"[...] 33 Ajo procedurë përfundoi me 29 shtator 2015, kur Gjykata e Apelit nxori vendimin [PN. nr. 499/2015], me t*ë* cilin hodhi poshtë si të pabazuar kërkesën për rishikim t*ë* procedurës, ne pajtim me nenin 423, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 i KPPK-se, i cili përcakton standardet qe duhet te plotësohen si baz*ë* për rishikimin e procedurës.

34. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se në këtë procedurë gjykatat e rregullta vendosen vetëm për plotësimin e kërkesave procedurale për rishikimin e procedurës, dhe jo për meritat e rastit, i cili përfundoi me aktgjykimin e formës se prer*ë* t*ë* Gjykatës Supreme me 12 shkurt 2015. [...]

37· Si e till*ë*, e drejta për gjykim t*ë* drejt*ë* dhe dëgjim publik nuk zbatohet për këto procedura. Prandaj, ankesa e parashtruesit të kërkesës për grupin e dyt*ë* t*ë* procedurave duhet t*ë* refuzohet si e papajtueshme *ratione materiae* me Kushtetutën, për shkak se një kërkesë për rishikim të procedurës penale nuk mund të përcaktojë një vepër penale sipas Kushtetutës (Shih, me analogji, *Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për te Drejtat* e *Njeriut të* 10 *prill 2001, nr. 36445/97, paragrafi 86)*".

Siç mund të vërehet, këtu Gjykata Kushtetuese ka përdorur vetëm një precedent, precedentin *Sablon kundër Belgjikes, kërkesa nr. 36445/97, § 86, 10 prill 1997*, dhe atë vetëm një paragraf i tij, paragrafi 86. I njëjti është përdorur edhe në tri vendimet e tjera që diskutohen në vijim të këtij punimi: në ndërkohë që nga ky precedent. Në rastin e precedentëve të tjerë q*ë* ka përdorur në katër vendimet që diskutohen këtu, **Gjykata Kushtetuese** nuk ka përdorur asnjë paragraf: vendimet e Strasburgut janë përdorur pa ua cituar as edhe një paragraf i vetëm i tyre për t'i treguar lexuesit dhe palëve në procedurë se si këto precedentë shkojnë me anën faktike dhe juridike të rasteve që janë vendosur.

Para se të kalojmë në rastin e dytë, shënojmë edhe faktin tjetër se precedent i Strasburgut që ka përdorur Gjykata në rastin e parë ka të bëjë me një rast civil, një procedurë falimentimi, si dhe me një kërkesë për përsëritje të procedurës. **Gjykata e Strasburgut** ka gjetur se kërkesa e palës ka qenë e bazuar, përkatësisht se pasur shkelje të nenit 6.1 të Konventës. Kjo gjetje, megjithatë, ka pasur të bëjë me një procedurë të re, jo me ekzekutim të vendimit e as me kërkesën origjinale për përsëritje të procedurës.

Në çështjet civile, përsëritja e procedurës së përmbarimit nuk lejohet sipas mjeteve të jashtëzakonshme, as në Kosovë e as gjetiu. Kjo e bën edhe më absurd përdorimin nga ana e **Gjykatës Kushtetuese** të këtij precedenti civil. Kjo, në thelb, parqet një cenim shtesë të lirive dhe të drejtave të njeriut të garantuara me kushtetutë të parashtruesit të kërkesës në këtë rast. Me mohimin e kontrollit kushtetues të vendimit të fundit me të cilin pala ka pohuar shkelje kushtetuese, përkatësisht të *Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN. nr.499/2015, te 29 shtatorit 2015*, i cili ka qenë objekt i kontrollit kushtetues, Gjykata ka bërë shkelje të nenit 32 të Kushtetutës,[203] me kuptim mjetin juridik nga neni 113.7 i Kushtetutës. Cenimi i të drejtës për ankesë kushtetuese ka ndodhur për arsye se akti juridik individual që ka qenë objekt kontrolli kushtetues ka ngelur pa përgjigje sa i përket kushtetutshmërisë së tij. Legjitimiteti kushtetues i Aktvendimit të Gjykatës së Apelit si më sipër nuk dihet. E thënë ndryshe, duke u marrë me kërkesën origjinale për përsëritje të procedurës, Gjykata në këtë rast i ka mohuar palës të drejtën për mjet juridik nga neni 32 i Kushtetutës, që nënkupton ankesën

---

[202] *Rasti KI 159/15. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Sabri Ferati. Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë se Aktvendimit të Gjykatës së Apelit te Kosovës, PN. nr.499/2015, të 29 shtatorit 2015*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë: 13 qershor 2016. Nr. ref.:RK947/16.

[203] Neni 32 ["E Drejta për Mjete Juridike"] i Kushtetutës:
"Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj."

kushtetuese nga nenit 113.7 e Kushtetutës, për shkak se parashtruesi i ankesës kushtetuese nuk ka marrë përgjigje lidhur me cilësinë kushtetuese (kushtetutshmërinë) të vendimit që ka qenë objekt kontrolli kushtetues.

16.12.2.4. Rasti i dytë: Rastet KI 80/15, KI 81/15 dhe KI 82/15 (të bashkuara).

Ky rast përfshinë një grup rastesh[204], në të cilat objekt i kërkesës origjinale të parashtruesve pranë gjykatave të rregullta ka qenë ekzekutimi i kontratave të caktuara kundrejt një borxhi të papaguar të ish - **TMK** ("Trupat e Mbrojtjes së Kosovës"). Pasi kanë dështuar në realizimin e kërkesës për nxjerrjen e borxhit nga **TMK** në të gjitha instancat, parashtruesit kanë kërkuar përsëritjen e procedurës përmbarimore, kërkesë që u është refuzuar në **Gjykatën e Apelit** (sipas ankesës).[205]. Kjo instancë gjyqësore ka konstatuar se, ligjërisht, nuk lejohet përsëritja e procedurave përmbarimore në kontestet civile.[206] Më herët e thamë që kështu është edhe në sistemet tjera juridike në Evropë.

Pas këtyre veprimeve, që hyjnë në kategorinë e veprimeve që pala duhet t'i ndërmarrë për ta plotësuar kriterin e shterjes së mjeteve juridike në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës, parashtruesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Plotësimi i kriterit të shterjes së mjeteve juridike përbën njërin prej dy kushteve kushtetuese për pranueshmëri të trajtimit të meritave të rastit. Kjo rrethanë ka bërë që objekt kontrolli kushtetues të jenë vendimet e Gjykatës së Apelit, diçka që reflektohet qartë në titullin e vendimit të Gjykatës për këtë rast. Kjo rrethanë, megjithatë, për Gjykatën del e paqartë më vonë kur ajo këtë objekt të kontrollit kushtetues, i cili mbështetet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe që asnjëherë nuk ndryshon sepse çdoherë duhet të ekzistojë një akt i një autoriteti publik që sfidohet, e shndërron në kërkesë për përsëritje të procedurës. Kriteri i shterjes së mjeteve juridike bën që, si kriter kushtetues, të jetë, zakonisht, akti që sfidohet akti individual i instancës së fundit gjyqësore apo administrative (në raste më të rralla).

Paqartësia e sipërcekur e Gjykatës manifestohet në paragrafin 25 të vendimit për këtë rast, ku është thënë si vijon:

"[...] Gjykata rikujton se parashtruesi inicioi dy procedura që kane të bëjnë me kërkesat KI 80/15, KI 81/15 dhe KI 82/15: procedurën përmbarimore dhe përsëritjen e procedurës përmbarimore. Gjykata do të kufizohet në përsëritjen e procedurës përmbarimore, pasi që ajo është objekt i çështjes se kërkesave dhe ajo është gjithashtu hapi i fundit procedural i tërë procesit të mbajtur në gjykatat e rregullta".

Siç dihet nga teoria dhe praktika e gjyqësisë kushtetuese krahasimore, juridiksioni i ankesave kushtetuese të llojit të plotë ose gjysmë të plotë i jep mundësi për adresimin në plotni të shkeljes kushtetuese të kryer në procedura para se çështja të ngritet në Gjykatën Kushtetuese. Si i tillë, juridiksioni sipas ankesës kushtetues bën pjesë në juridiksion të tërthortë (juridiksion joorigjinal). Kjo është kështu sepse çështja duhet të jetë njëherë e trajtuar dhe vendosur nga juridiksionet e përgjithshme, gjyqësore dhe të tjera, para së të kalojë në Gjykatën Kushtetuese. Kjo është pasojë e një kriteri përgjithësisht të pranuar nga shtetet që kultivojnë ankesat e plota kushtetuese. Ai quhet kriteri i shterjes së mjeteve juridike efektive në kuadër të sistemit nacional juridik–kushtetues. Kjo nënkupton se çështja origjinale që ka nisur në instancat e tjera nacionale të vendosjes shndërrohet në një çështje me objekt kushtetues, si pasojë e vendimit të fundit të marrë nga instancat nacionale të vendosjes. Këto instanca zakonisht i takojnë gjyqësorit të rregullt.

Ky sqarim u bë për të treguar se paragrafi i sipërcekur në arsyetimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese ngatërron kërkesën origjinale të palëve për përsëritje të procedurës, si **petitum** fillestar që është shqyrtuar meritorisht në **Gjykatën Themelore të Prishtinës**, me hapat proceduralë që më pas ata i kanë ndërmarrë në dy instancat tjera (sipas ankesës dhe revizionit respektivisht). Këto veprime procedurale në tri shkallët

---

[204] *Rastet nr. KI80/15, KI81/15 dhe KI82/15 (te bashkuara). Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues Rrahim Hoxha. Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktvendimeve te Gjykatës së Apelit. Ae.nr.188/2014,189/2014, të 19 janarit 2015, dhe Aktvendimin Ae. nr. 190/2014, të 20 janarit 2015.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 27 dhjetor 2016. Nr. ref.:1028/16.

[205] Ibid., paragrafët 20-21.

[206] Ibid., paragrafi 19.

gjyqësore kanë prodhuar tri lloje të vendimeve. Vetëm vendimi i instancës së dytë ka marrë formën e prerë dhe ka qenë objekt i kontrollit kushtetues (revizioni në rastet e kërkesave për përsëritje të procedurë së përmbarimit nuk është mjet efektiv juridik).

Kjo është kështu si pasojë e redaktimit të nenit 113.7 të Kushtetutës, që sanksionon ankesën e plotë kushtetuese në Kosovë, gjithnjë me supozim që çështja e ngritur ka të bëjë me kushtetutshmërinë (konsideratat e ligjshmërisë nuk mund të jenë objekt kontrolli në **Gjykatën Kushtetuese**, siç është rasti në disa vende tjera në **Evropë**). Nga kjo del qartë se objekt i kontrollit kushtetues nuk kanë qenë dhe nuk mund të jenë veprimet procedurale të palëve që kanë të bëjnë me kërkesën origjinale për përsëritje të procedurës. Kjo sepse kushtetutshmëria e tyre dhe e veprimeve të tjera procedurale të parashtruesit nuk mund të jenë dhe nuk janë objekt i kontrollit kushtetues. Kjo e bën të pakuptimtë arsyetimin si më sipër të **Gjykatës Kushtetuese**, i dhënë në paragrafin 25 të vendimit të sipërcituar.

Arsyeja pse Gjykata ka dhënë këtë arsyetim, i cili në një mënyrë arbitrare shndërron në objekt kontrolli kushtetues veprimet procedurale të palës të ndërmarra në instancën e parë pranë **Gjykatës Themelore në Prishtinë**, ka të bëjë me faktin se përmes tij është ndërtuar shtylla e parë e shkakut për papranueshmëri. Shtylla kryesore dhe "vdekjeprurëse" për kërkesën e parashtruesit dhe, për pasojë, për liritë dhe të drejtat e tij kushtetuese, vjen në pjesën e paragrafëve që thërrasin në ndihmë, në mënyrë krejtësisht jo kritike, precedentët e **Gjykatës së Strasburgut**, gjithnjë me shpresën se të njëjtit i përgjigjen situatës faktike dhe juridike të rastit që diskutojmë. Siç do të arsyetojmë në seksionin tjetër, kur analizojmë precedentët e **Strasburgut** që janë përdorur nga Gjykata, ata fare nuk i përgjigjen këtij rasti: përzgjedhja dhe interpretimi i tyre ka qenë në tërësi arbitrar.

Me mohimin e kontrollit kushtetues të vendimit të fundit me të cilin pala ka pohuar shkelje kushtetuese dhe që ka qenë objekt i kontrollit kushtetues, Gjykata Kushtetuese ka bërë vetë shkelje të nenit 32 të Kushtetutës, me kuptim mjetin juridik nga neni 113.7 i Kushtetutës, përkatësisht cenimin e të drejtës për ankesë kushtetuese objekti së cilës ka ngelur pa përgjigje lidhur me legjitimitetin e tij kushtetues. E thënë ndryshe, duke u marrë me kërkesën origjinale për përsëritje të procedurës, **Gjykata Kushtetuese** ka mohuar të drejtën e palës për mjet juridik, me kuptim ankesën kushtetuese, sepse parashtruesi ka ngelur pa përgjigje lidhur me cilësinë kushtetuese (kushtetutshmërinë) të vendimit objekt kontrolli kushtetues në këtë rast.

T'i kthehemi rastit të tretë në vijim, për të parë shndërrimin e kërkesës themelore të palës të parashtruar dhe vendosur nga gjyqësori i rregullt në një objekt kontrolli kushtetues pranë Gjykatës Kushtetuese, në mënyrë të ngjashme me këtë që e thamë më sipër.

16.12.2.5. Rasti tretë: Rasti KI 07/17

Rasti i tretë ka të bëjë me një çështje penale me dy procedura. Procedurat për të cilat bën fjalë kërkesa fillestare e palës janë të ndryshme nga ajo që ka konstatuar **Gjykata Kushtetuese**. Bëhet fjalë për procedurën e rregullt penale dhe për kërkesën për përsëritje të procedurës.[207] Pala është ankuar në Gjykatën Kushtetuese për cenim të një morie të drejtash kushtetuese, përfshirë të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm nga neni 31 i Kushtetutës lidhur me nenin 6 të Konventës.

Ajo që ka rëndësi për diskutimin tonë këtu lidhet me objektin e kontrollit kushtetues, i cili është i njëjtë si në dy rastet e sipërcekura, përkatësisht me kontrollin kushtetues të dy vendimeve të formës së prerë: njëri i takon Gjykatës së Apelit dhe tjetri Gjykatës Supreme. Për dy këto vendime, Gjykata Kushtetuese ka konstatuar për sa vijon:

[207] *Rasti KI 07/17. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Pashk Mirashi Vlerësim i kushtetutshmërisë se Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 228/2016, te 20 tetorit 2016 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PAKR nr. 231/2015, te 6 gushtit 2015.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 12 qershor 2017. Nr. ref.: RK 1091/17.

"[...] 62. Gjykata vëren se ne këtë procedurë, gjykatat e rregullta vendosën vetëm lidhur me përmbushjen e kërkesave procedurale për rishikimin e procedurës penale dhe jo për meritat e rastit.

63. Gjykata thekson se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] i Kushtetutës, *"të drejtat e njeriut dhe liritë themelore te garantuara* me *këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat* e *Njeriut".*

64. Sa i përket pretendimit të parashtruesit te kërkesës për shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata, duke iu referuar praktikes gjyqësore te GJEDNJ-se dhe praktikes gjyqësore te saj, përsërit se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së nuk zbatohen në kërkesat për rishikimin ose përsëritjen e procedurës. (Shih, në mënyrë analoge rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI 159/15, *Sabri Ferati,* Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2016, paragrafi 37; KI 80/15, 81/15 dhe 82/15, *Rrahim Hoxha,* Aktvendim për papranueshmëri, i 27 dhjetorit 2016, paragrafi 31, shih gjithashtu rastet e GJEDNJ-se, *inter alia, Oberschlick kundër Austrisë,* nr. 23727/94, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 marsit 1994, *Dowsett kundër Mbretërisë së Bashkuar,* nr. 8559/08, Aktvendim për papranueshmëri i 4 Janarit 2011, *Sablon kundër Belgjikës,* nr. 36445/97, Aktgjykim i 10 prillit 2001, paragrafi 86).

65. Për më tepër, Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së e cila konstaton se neni 6 nuk zbatohet në procedurat për rishikimin e ndonjë rasti sepse një person dënimi i të cilit është bërë i plotfuqishëm dhe i cili bën kërkesë për rishikimin e rastit te tij nuk është "akuzuar për vepër penale" brenda kuptimit të atij neni (shih rastet e GJEDNJ *Franz Fischer kundër Austrisë* nr. 27569/02, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 majit 2003).

66. Gjykata konsideron se pajtueshmëria *ratione materiae* e kërkesës me Kushtetutën rrjedh nga juridiksioni material i Gjykatës. *"E drejta në të cilën thirret parashtruesi i kërkesës duhet të mbrohet me Kushtetutë në mënyrë që një ankesë kushtetuese të jetë në pajtueshmëri ratione materiae* me *Kushtetutën."* (Shih rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI 80/15, 81/15 dhe 82/15, *Rrahim Hoxha,* Aktvendimi për papranueshmëri, i 27 dhjetorit 2016, paragrafi 31).

67. Prandaj, Gjykata konsideron se ankesat e parashtruesit lidhur me refuzimin nga gjykatat e rregullta për të rishikuar procedurën penale nuk janë **ratione materiae** në pajtim me nenin 31 te Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të **KEDNJ**-së".

Nga kjo si më sipër shihet qartë se Gjykata ka ndjekur rrugën e trasuar në dy vendimet e diskutuara më lart. Këtë fakt ajo e përligjëson duke recituar praktikën e vet. Sa i përket praktikës së Strasburgut, janë disa gjëra që bien në sy dhe të cilat dëshmojnë katërçipërisht se edhe këtu bëhet fjalë për cenimin e të drejtës së parashtruesit për mjet juridik nga neni 32 i Kushtetutës.

Praktikën gjyqësore të Strasburgut e diskutojmë në seksionin në vijim. Këtu mjafton të shënojmë se nga tri rastet e **Gjykatës së Starsburgut**, vetëm njërin nga to Gjykata e ka përzgjedhur për t'ia cituar një paragraf, paragrafin 86, njëjtë si në vendimin pararendës. E kemi fjalën për vendimin e Strasburgut në rastin *Sablon kundër Belgjikës.* E shënojmë këtë sepse ka rëndësi të dihet që citimet e rasteve të Strasburgut janë bërë vetëm për sy e faqe, jo për të bërë silogjizmin (nënvënien) e tyre gjyqësore me qëllim të zbatimit në rastin e kontrollit të kushtetutshmërisë së vendimeve të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme, të cilat kanë qenë objekt i kësaj procedure të vënë në lëvizje sipas ankesës kushtetuese të parashtruesit. Vendimet e sipërcekura nga Gjykata e Strasburgut, siç do të provohet në vijim të seksionit tjetër, kanë një kuptim dhe domethënie krejtësisht tjetër nga ajo që në mënyrë paushalle ua ka dhënë Gjykata Kushtetuese.

Nuk është kontestuese se neni 31 i Kushtetutës lidhur me nenin 6 të Konventës nuk zbatohen në kërkesat për përsëritje të procedurave sepse aty nuk ka pasur fare një procedurë. Këtë konstatim, megjithatë, duhet ta bëjnë gjykatat e rregullta sepse edhe ato janë të detyruara sipas nenit 53 të Kushtetutës që, në mënyrë të njëjtë, të zbatojnë standardet minimale nga Konventa që janë ndërtuar nga interpretimet e **Gjykatës së Strasburgut**. Sikur ky të kishte qenë rasti, gjërat do të ishin më ndryshe, nisur nga fakti se gjykatat

e rregullta kanë juridiksion origjinal për të vepruar sipas kërkesave për përsëritje të procedurës. Ky nuk është rasti, ndërkaq, kur bëhet fjalë për Gjykatën Kushtetuese dhe kërkesat sipas nenit 113.7 të Kushtetutës. Këtu nuk gjykohet dhe vendoset për kërkesën origjinale lidhur me përsëritjen e procedurës, por për kushtetutshmërinë e tërësishme, formale dhe substanciale, të një vendimi gjyqësor të formës së prerë të dhënë në përgjigje ndaj kërkesës së palës për përsëritje të procedurës.

Siç mund të vërehet fare lehtë, këtu bëhet fjalë për dy juridiksione; njëri origjinal, që u takon gjykatave të rregullta dhe të cilat po ashtu mund të bazohen drejtpërdrejtë në standardet e Strasburgut nga neni 6 i Konventës; dhe tjetri juridiksion, ai derivativ që buron nga neni 113.7 i Kushtetutës. Në juridiksionin e fundit, për të qenë kërkesat e pranueshme duhet të posedojnë dy cilësi: një, objekti i kontrollit kushtetues duhet të jetë çdoherë një vendim individual i një autoriteti publik; dhe dy, që ai vendim të jetë i formës së prerë (në parim), pra kundër tij pala t'i ketë ushtruar të gjitha mjetet e goditjes juridike që i ofron rendi juridik-kushtetues kosovar.

Në rastin që diskutojmë, **Gjykata Kushtetuese** ka konstatuar se e drejta në të cilën thirret parashtruesi i kërkesës duhet të mbrohet me Kushtetutë *në* mënyrë që një ankesë kushtetuese të jetë **ratione materiae** në pajtueshmëri me Kushtetutën, pa kuptuar se garancionet procedurale, siç janë këto nga neni 6 i Konventës lidhur me nenin 3 të Kushtetutës paraqesin të drejta të natyrës procedurale kushtetuese. Të tilla janë edhe, ta zëmë, e drejta për mosgjykim dy herë për të njëjtën vepër (parimi **ne bis in idem**), kurse të natyrës materiale janë ato që konceptualisht parashikohen dhe garantohen me Kushtetutë (e drejta e pronës, e drejta për jetë etj.). Si të parat ashtu dhe të dytat duhet të mbrohen në të gjitha fazat dhe llojet e procedurave juridike në nivel nacional. Konventa vë standardet minimale për mbrojtjen dhe sigurimin e tyre, siç do të shihet në vijim. **Gjykata Kushtetuese**, ndërkaq, ka për detyrë të vetme, në kuptim të juridiksionit nga neni 113.7 i Kushtetutës, të mbikëqyrë kushtetutshmërinë me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës. Kjo mbikëqyrje realizohet përmes kontrollit kushtetues të vendimeve juridike (dhe të veprimeve që prodhojnë pasoja juridike) të natyrës individuale të organeve publike në Kosovë me qëllim të konstatimit nëse organet e tilla kana realizuar siç duhet juridiksionin e tyre të garantuar me Kushtetutë dhe ligje vendore. Në çdo rast kur ato vendime janë jo kushtetuese, aty ka shkelje (cenim) të lirive dhe të drejtave të parashtruesve të kërkesës. Kualifikimi juridik që parashtruesit e bëjnë nuk duhet të çojë asnjë peshë sepse përfaqësimi me avokat nuk është i detyrueshëm. Për këtë shkak, **Gjykata Kushtetuese** ka detyrim që çdoherë të zbulojë cilësimin kushtetues që shpërfaq nivelin real të legjitimitetit kushtetues të vendimit të një autoriteti publik që është objekt kontrolli kushtetues.

Këto, si më sipër, do të bëhen edhe më të qarta kur lexuesi të sheh diskutimin e përmbajtjes së vendimeve të Strasburgut që Gjykata Kushtetuese i ka cituar në mënyrë paushalle në mbështetje të vendimeve të saj si më sipër, përfshirë vendimin që këtu ishte objekt diskutimi.

Tani i kthehemi rastit të katërt dhe të fundit të dhënë në vijim të zbatimit arbitrar të nenit 6 të Konventës lidhur me garancionet procedurale kushtetuese nga neni 31 i Kushtetutës.

16.12.2.6. Rasti i katërt: *Rasti KI 40/19*

Ky rast ka natyrë të çështjes civile kontestimore, me objekt kontrollin e kushtetutshmërisë së vendimit të **GSK.**[208] Edhe këtu, parashtruesi kishte pohuar cenimin e lirive dhe të drejtave materiale që janë kryer, sipas parashtruesit, në një procedurë gjyqësore. Ajo procedurë gjyqësore, në origjinal, kishte të bënte me vërtetimin e pronësisë së trashëguar. Në ndërkohë që parashtruesit kanë humbur kontestin, kanë kërkuar përsëritjen e procedurës, bazuar në cenimin e të drejtave nga neni 31 i Kushtetutës lidhur me nenin 6 të Konventës. Ata janë fokusuar në veçanti në arbitraritetin e shprehur nga gjyqësori i rregullt gjatë administrimit dhe marrjes së provave në shkallë të parë.

---

[208] *Rasti KI 40/19. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Alije Shabani, Lulëzim Shabani, Luljeta Shabani dhe Kujtim Shabani. Vlerësim i kushtetutshmërisë se Aktvendimit te Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 394/2018, te 14janarit 2019.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, me 07 tetor 2019. Nr. Ref.:RK 1440/19.

Gjykata Kushtetuese edhe këtu ka dhënë arsyetimin e njëjtë si në rastet më sipër, duke shndërruar në tërësi kontestin kushtetues në kontest rreth përsëritjes së procedurës dhe duke vënë sërish në dukje se e drejta për përsëritje të procedurës fare nuk hyn në garancionet kushtetuese, të cilat në esencë janë një korpus që përbëjnë esencën e një të drejte me natyrë materiale. Për më tepër, ajo fare nuk ishte lëshuar në pohimin e parashtruesve se atyre iu është cenuar e drejta për pronë. Kjo është bërë për shkak se ajo ka ndërtuar papranueshmërinë mbi kurrizin e moszbatimin *ratione materiae* të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të Konventës, në çështjet që vetë i ka vlerësuar se bëjnë pjesë në "përsëritje të procedurës".[209] Në paragrafët arsyetues 39-42 të këtij vendimi për papranueshmëri si më sipër, Gjykata Kushtetuese ka përdorur gjuhën identike më atë të përdorur në vendimet e mëhershme, duke mos cituar asnjë paragraf të precedentëve të Strasburgut dhe pa treguar se si precedentët e tillë pajtohen në aspektin juridik dhe faktik me rastin e vendosur këtu.

Për arsye si më sipër, ajo që është thënë më lartë lidhur me tri rastet vlen, *mutatis mutandis*, edhe për këtë rast. Për më tepër, këtu e shohim të arsyeshme të theksojmë se instituti i përsëritjes së procedurës përbën një mjet juridik efektiv dhe autonom që normohet në detaje me norma juridike të secilës procedurës (administrative, civile dhe penale). Si i tillë, ky institut bën pjesë në arsenalin konceptual të dispozitës së nenit 32 të Kushtetutës, që thotë në mënyrë shprehimore se e drejta për mjete juridike përdoret nga secili person në një mënyrë që është e përcaktuar me ligj. Të gjitha ligjet sistemike të fushës penale, civile dhe administrative parashikojnë institutin e përsëritjes së procedurës, si një mjet juridik autonom dhe efektiv. Kështu është, pa asnjë përjashtim, në të gjitha sistemet juridike evropiane dhe më gjerë.

16.13.Standardet e Strasburgut në rastet e përsëritjes së procedurës

Në këtë nënseksion analizohen rastet e Strasburgut që i ka cituar **Gjykata Kushtetuese** në të gjitha vendimet si më sipër, pa treguar në asnjë rast mënyrën se si pajtohen këta precedentë me rastet që ajo vetë i ka vendosur, si në aspektin juridik ashtu dhe në atë faktik. Renditja e shqyrtimit të tyre është ashtu siç janë cituar në vendimet e sipërcekura të viteve 2016-2019 të Gjykatës, pa marrë parasysh vitet kur ato janë krijuar në Strasburg. Kjo do të thotë se kemi ndjekur renditjen ashtu siç këto janë përdorur nga **Gjykata Kushtetuese** me rastin e vendosjes së katër rasteve si më sipër.

Për rolin dhe pozitën kushtetuese të precedentëve të Strasburgut si burim formal i të drejtës kushtetuese në Kosovë folëm më sipër.

16.13.1.Precedenti i parë: *Zawadzki kundër Polonisë* (dec), nr. 34158/96, 6 korrik 1999

Në pikën tre të këtij vendimi, **Gjykata e Strasburgut** ka theksuar dy gjëra: e para, se garancitë procedurale nga neni 6.1 i Konventës nuk gjejnë zbatim në një procedurë për ekzekutim të vendimit dhe as në procedurat që në mënyra të ligjshme mund të rihapen në të ardhmen: ato zbatohen vetëm sa i takon procedurave që janë mbyllur me vendim të formës së prerë; dhe e dyta, se përsëritja e procedurës së mbyllur me një vendim të formës së prerë nuk hyn në garancitë procedurale të njohura me Konventë.[210] Nga kërkesat e paraqitura në këtë rast, Strasburgu ka njohur si të pranueshme vetëm ato që kanë të bëjnë me zgjatjen jo

[209] Ibid., paragrafët 43-44.

[210] **COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME / EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS.** *QUATRIÈME SECTION. DÉCISION PARTIELLE SUR LA RECEVABILITÉ de la requête n° 34158/96 présentée par Józef ZAWADZKI contre la Pologne.* Në internet: https://sip.lex.pl/orzeczenia-i-pisma-urzedoëe/orzeczenia-sadow/ 34158-96-zawadzki-v-polska-decyzja-europejskiego-520619086 (shikuar në janar 20020).

të arsyeshme të procedurave, pikë në të cilën parashtruesi i kërkesës ka fituar.[211] Kërkesa bazike (origjinale) ka pasur të bëjë me realizimin e të **drejtës në pronë** dhe të **drejtës në pension invalidor të kategorisë së dytë**. Kërkesa për përsëritje të procedurës ka qenë kërkesë periferike dhe i ka takuar ekskluzivisht procedurës së ekzekutimit.[212]

Nëse kihet parasysh fakti se Strasburgu cakton vetëm standardet minimale lidhur me liritë dhe të drejtat e njeriut, në këtë rast garancitë minimale procedurale nga neni 6 i **KEDNJ,** atëherë qartë shihet se këtu **Gjykata Kushtetuese** ka bërë një interpretim të gabuar duke e futur në kategorinë **ratione materiae** kërkesën për përsëritjen e procedurës që është paraqitur në gjykatat e rregullta të Kosovës, si gjykata të juridiksionit të përgjithshëm. Nuk mund të shërbejnë arsyetimet e **Gjykatës së Strasburgut** lidhur me juridiksionin e saj **ratione materiae** si pikë referimi për përcaktimin e lirive dhe të drejtave të garantuara me kushtetutat nacionale të vendeve palë në Konventë. Kjo është kështu sepse, në nivel nacional, përfshirë rastin e Kosovës, e drejta materiale kushtetuese që cenohet dhe që është objekt kërkese nga ana e palës nuk është e njëjtë me të drejtën materiale nga Konventa, e cila, siç u tha, nuk përcakton liri dhe të drejta por standard për liritë dhe të drejtat e caktuara, duke ua lënë shteteve lirinë dhe të drejtën e vlerësimit të fakteve dhe provave, si dhe lirinë dhe të drejtën e normimit të caktuar të marrëdhënieve shoqërore.

Në rastin konkret për të cilin flasim, **Gjykata Kushtetuese** ka ngatërruar tri gjëra në të njëjtën kohë: e para, ka ngatërruar objektin e procedurës me objektin e kërkesës së palës; dy, ka ngatërruar juridiksionin material të Gjykatës nga neni 113.7 i Kushtetutës me të drejtat materiale nga neni 31 i Kushtetutës, të cila në **Gjykatën e Strasburgut** trajtohen si garanci procedurale minimale për të gjitha procedurat juridike; dhe, së fundi, në mënyrë jokritike ka futur një institut dhe mjet juridik, përsëritjen e procedurës, në kuadër të garancive procedurale nga neni 6.1 i Konventës lidhur me nenin 31.1 i Kushtetutës. Shënojmë këtu se **Gjykata Kushtetuese** citon këtë precedent pa dhënë asnjë paragraf të vendimit të pjesshëm mbi papranueshmërinë, versioni i të cilit ekziston vetëm në gjuhën frënge, duke ia pamundësuar palës dhe lexuesit kosovar të kuptojnë se si pajtohet ky precedent i Strasburgut me qëndrimin e saj të shprehur në vendim (**sic**!).

Ky precedent, si çdo precedent i Strasburgut, përmban analizën e anës faktike dhe juridike të rastit. Për t'u zbatuar në nivel nacional, me qëllim të harmonizimit të rendit të brendshëm juridik me standardet e ngritura nga **Gjykata e Strasburgut**, një precedent duhet të plotësojë dy kushte: e para, precedenti duhet të ketë të bëjë me shtetin që është palë në Konventë dhe palë e paditur në precedent; dhe, e dyta, ana faktike dhe juridike e precedentit duhet në tërësi të jenë identike me rastin nacional që matet me precedentin e Strasburgut. Sikundër u pa nga sa më sipër, kërkesa e palës në Strasburg nuk ka pasur të bëjë fare me përsëritjen e procedurës, kurse ankesa e saj për cenim të garancive procedurale që kanë të bëjnë me kërkesën për përsëritjen e procedurave të ekzekutimit në nivel nacional ka qenë periferike. Sa i përket kushtit i të qenit anëtar i Konventës, **Kosova** nuk ka problem sepse njëanshëm ka pranuar këtë*ë* instrument si burim të detyrueshëm të së drejtës kushtetuese, së bashku me interpretimet e saj që bëhen në Strasburg.

Në vijim diskutojmë elemente të tjera që e bëjnë vendimmarrjen e **Gjykatës Kushtetuese** më me defekte, krejt kjo si pasojë e natyrës juridike të precedentëve të Strasburgut kur nga to kërkohet të prodhojnë efekt juridik në nivel nacional.

---

[211] **COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME / EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS** QUATRIEME SECTION **AFFAIRE ZAWADZKI c. POLOGNE** *(Requête n° 34158/96)*ARRÊT STRASBOURG 20 décembre 2001DÉFINITIF 27/03/2002. Paragrafët 68-109. N*ë* internet: https://sip.lex.pl/ orzeczenia-i-pisma-urz edowe/orzeczenia-sadow/34158-96-zawadzki-v-polska-wyrok-europ ejskiego-520957187 (shikuar në janar 2020).

[212] **COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME / EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS.** *QUATRIÈME SECTION. DÉCISION PARTIELLE SUR LA RECEVABILITÉ de la requête n° 34158/96 présentée par Józef ZAWADZKI contre la Pologne*, **EN FAIT**, paragrafi 1.

16.13.2.Precedenti i dytë: *Sablon kundër Belgjikës,* kërkesa nr. 36445/97, § 86, 10 prill 1997

Ky precedent po ashtu *ë*shtë shqyrtuar në dy faza, atë të lejueshmërisë[213] dhe të vendosjes definitive mbi meritat e rastit[214]. Në rastin e dytë, **Gjykata e Strasburgut** ka gjetur cenim të nenit 6.1 të Konventës për shkak të stërzgjatjes së procedurave ndaj kërkuesit në mënyrë të paarsyeshme. Edhe ky vendim është vetëm në gjuhën frënge.

Ankesa kryesore e palës në këtë precedent ka pasur të bëjë me stërzgjatjen e paarsyeshme të procedurave të falimentimit, të cilat kanë rezultuar në cenimin e të drejtave të tij pronësore. Esenca e të drejtës së parashtruesit është bazuar në një procedurë të fituar për anulim të falimentimit kundër tij në vitin 1993. Pala ka kërkuar që të konstatohet zvarritja e paarsyeshme e procedurave, si në aspektin e kërkesës origjinale për fitimin prapa të pronësisë dhe aseteve si pasojë e prishjes së procedurave të falimentimit ndaj tij, ashtu dhe në aspektin e procedurave që janë zhvilluar më pastaj sipas kërkesës për përsëritje të procedurës.

Në këtë rast, **Gjykata e Strasburgut** ka konstatuar se, në parim, përsëritja e procedurës nuk mbulohet në kuadër të garancive procedurale nga neni 6.1 i Konventës, gjë që është e arsyeshme sepse nuk ka pasur procedurë. Mirëpo, sipas Strasburgut, kur kërkesa *është* lejuar dhe ka rifilluar procedura për objektin dhe subjektin e njëjtë civil, atëherë aty në tërësi vlejnë kriteret dhe garancitë procedurale nga neni 6.1 i Konventës (qoftë në çështjet civile, penale, administrative dhe në procedurat tjera ku vendoset për liritë dhe të drejtat e njeriut).[215] Ky vendim ka konstatuar se procedura e përsëritur që ka ndodhur *ë*shtë dashur të përfshihet me garancitë e nenit 6.1 të Konventës. Në fund, megjithatë, Gjykata e Strasburgut ka konstatuar se në këtë rast nuk ka pasur cenime të këtij neni të Konventës në procedurën e përsëritur.[216] Në vendimin e **Gjykatës Kushtetuese**, ndërkaq, nga tërë ky vendim *është* shkëputur vetëm paragrafi 86 i tij, i cili, në përkthim *ad literam* lidhur me përsëritjen e procedurës, thotë për sa vijon:

"[...] 86. Sipas jurisprudencës, neni 6 i Konventës, në fakt, nuk gjen zbatim në procedurat e vlerësimit të një kërkesë që synon revidimin e t*ë*rësishëm të një procesi civil (J.F. C. France (decision), n. 39616/19, 20.04.99). Apo, procedura e dështimit të falimentimit, e nisur sipas kërkesës civile, duhet të asimilohet (shkrihet) në procedurën për revidim (revizion). Për pasojë, procedura e nisur më 23 prill 1990 nuk mund të këtë, në origjinë, ndikim në të drejtat dhe detyrimet e karakterit civil në kuptim të nenit 6 të Konventës".

Me procedurë të datës 23 prill 1990 nënkuptohet procedura që ka pasur të bëjë me rishikimin e falimentimit dhe që *ë*shtë mbyllur me sukses në favor të pal*ë*s k*ë*rkuese me një aktgjykim të vitit 1993. Kjo do të thotë se neni 6 i Konventës nis të zbatohet vetëm atëherë kur ka pasur procedura të zhvilluara në tërësi nga fillimi. Kjo *ë*shtë kështu sepse shteteve, jo gjykatave nacionale kushtetuese dhe gjykatave të tjera, u lejohet që vetë të parashikojnë procedurat dhe garancitë procedurale minimale për vënien në jetë të lirive dhe të drejtave nga Konventa. Ajo që gjendet në dispozitat e neni 6 të Konventës nuk është e drejtë e veçantë por garancinë procedurale për të gjitha procedurat gjyqësore dhe procedurat tjera që zhvillohen në nivel nacional, të cilat shtetet kanë liri të rregullimit normimit kushtetues dhe ligjor në një mënyrë të caktuar, gjithnjë duke qenë nën mekanizmin dhe syrin vëzhgues të **Gjykatës së Strasburgut** sa i përket garancive minimale që ajo i ka vënë në kuptim të nenit 6 të Konventës. Vetëm atëherë kur vendi konkret

---

213 **COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS.** *DÉCISION SUR LA RECEVABILITÉ de la requête n° 36445/97 présentée par Emile SABLON contre la Belgique*. Në internet: https://sip.lex.pl/orzeczenia-i-pisma-urzedowe/orzeczenia-sadow/36445-97-sablon-v-belgia-decyzja-europe jskiego-520618741 (shikuar në janar 20020).

214 **COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS.** *TROISIÈME SECTION AFFAIRE SABLON c. BELGIQUE (Requête n° 36445/97). ARRÊT STRASBOURG 10 avril 2001. DÉFINITIF. 05/09/2001*. Në internet: https://www.doctrine.fr/d/CEDH/HFJUD/CHAMBER / 2001/CEDH001-63932 (shikuar në janar 2020).

215 Paragrafët 83-89 të vendimit definitiv në rastin ***Sablon kundër Belgjikës*** (2001).

216 Pika 1 & 2 e pjesës operative të vendimit definitiv në rastin ***Sablon kundër Belgjikës*** (2001).

ka shkelur parimin e subsidiaritetit, duke vendosur garancione nën nivelin e kërkuar sipas nenit 6 i Konventës, vjen në shprehje vlerësimi nga ana e **Gjykatës së Strasburgut** i lirisë së veprimit (**margin of appreciation**) që një shtet e ka pasur në dispozicion për të vënë në jetë standardet minimale të përcaktuara nga ajo.

Kjo marrëdhënie në mes të **Gjykatës së Strasburgut** dhe gjykatave nacionale është pasojë e barazisë sovrane të shteteve dhe e parimit të sovranitetit shtetëror që vepron në këtë mes. Ky nuk është rasti në raportin në mes të një gjykate kushtetuese dhe një gjykate supreme, as në Kosovë e as në ndonjë vend tjetër evropian. Kjo është kështu sepse, kur organet gjyqësore në nivel nacional vendosin në respektim të parimit të subsidiaritetit, ato vendosin për liritë dhe të drejtat e shtetasve të vet brenda kritereve kushtetuese dhe ligjore dhe janë të lira për një gjë të tillë. Kjo nënkupton se, kur **Gjykata Kushtetuese** vendos për kërkesën për përsëritjen e procedurës, sipas ankesës së plotë kushtetuese, siç është rasti me nenin 113.7 të Kushtetutës, ajo vendos për një mjet juridik dhe duhet të vlerësojë nëse mjeti juridik që mishërohet në institutin e përsëritjes së procedurës ka qenë i qasshëm dhe efektiv, pra jo një iluzion dhe fiktiv, për një palë që pretendon se organet gjyqësore dhe organet e tjera ia kanë mohuar një të drejtë të tillë.

Objekt i kërkesës për kontroll të kushtetutshmërisë sipas nenit 113.7 të Kushtetutës çdoherë është një akt individual i një autoriteti publik, kurse kërkesa e palës (**petitutimi**) konsiston në realizimin e një lirie dhe të drejte konkrete nga kapitujt II dhe III të Kushtetutës, që mund të jetë cenuar me vendimin e tillë. Kjo nënkupton se, në rastin konkret, **Gjykata Kushtetuese** duhet të vlerësojë nëse mjeti juridik i mishëruar në institucionin e përsëritjes së procedurës ka qenë efektiv dhe i qasshëm për palën, si dhe nëse vendimi i Gjykatës Supreme (apo i ndonjë gjykate apo organi tjetër në ndonjë procedurë gjyqësore apo administrative) ka qenë i arsyetuar dhe i bazuar në Kushtetutë dhe përcaktimet ligjore. Me këtë sqarim besoj se bëhet e qartë se vetë Gjykata Kushtetuese ka cenuar nenin 32 të Kushtetutës, duke e shpallur veten si jokompetente **ratione materiae** për të vendosur për një të drejtë konkrete të palëve.

Nuk mund të jetë një gjykatë kushtetuese jokompetente **ratione materiae** nëse në Kushtetutën e vendit ekziston e sanksionuar e drejta për **ankesë të plotë kushtetuese**, siç është rasti me nenin 113.7 të Kushtetutës. Kjo për arsyen e thjeshtë se objekt i kontrollit të kushtetutshmërisë sipas këtij neni *është* çdo vendim përfundimtar i çdo autoriteti publik, kurse kërkesa (**petitumi**) e palës çdoherë pohon se vendimi i tillë ka shkaktuar cenim të lirive dhe të drejtave nga kapitulli II dhe III i Kushtetutës. Edhe atëherë kur pala nuk bën kualifikimin e duhur juridik-kushtetues të kërkesës, siç ka ndodhur në këto katër raste që u diskutuan më sipër, vetë Gjykata Kushtetuese është ajo që duhet të trajtojë ankesën në mënyrë të duhur dhe jo të shpallet jokompetente **ratione materiae**. Për çështjet e pastra kushtetuese, si këto që janë objekt i këtyre katër vendimeve, Gjykata Kushtetuese nuk është në raport vertikal sovraniteti kundrejt **Gjykatës Supreme** dhe organeve të tjera, por në raport horizontal, si një autoritet shtetëror me monopol kushtetues për t'u kujdesur dhe siguruar supremacin*ë* (epërsinë) e Kushtetutës, jo të ikjes nga përgjegjësia përmes interpretimit t*ërës*isht të gabuar të precedentëve të **Gjykatës së Strasburgut**.

Si argument shtesë i kësaj shërben edhe redaktimi i nenit 23 ["Tërheqja e palës"] të **Ligjit nr. 03/L-121**, i cili thekson qartë se "Gjykata Kushtetuese do të vendosë për çështjet që iu janë referuar në mënyrë ligjore nga ana e palëve të autorizuara pavarësisht tërheqjes së palës nga procedura". Kjo dispozitë gjendet në pjesën e dispozitave të përgjithshme të **Ligjit nr. 03/L-121**, pra vlen për secilën procedurë të nisur pranë **Gjykatës Kushtetuese**. Si e tillë, kjo dispozitë përbën standard që gjendet në të gjitha vendet që kanë gjyqësi të ndara kushtetuese të modelit evropian/kelsenian dhe ka për qëllim që t'ua mundësojë gjykatave kushtetuese për të luajtur maksimalisht rolin e tyre të gardianit të kushtetutës dhe supremacisë (epërsisë) së saj, edhe atëherë kur palët për një arsye ose tjetër tërhiqen nga kërkesa e tyre fillestare. Kjo sepse supozohet që gjykatat kushtetuese çdoherë do të trajtojnë një çështje të ngritur kushtetuese kur një gjë të tillë e diktojnë interesat e mbrojtjes së kushtetutshmërisë nacionale.

16.13.3.Precedenti i tretë: *Steck-Risch dhe të tjerët kundër Lihtenshtajnit* (dec), nr. 29061/08, 11 maj 2010

Në k*ëtë* rast edhe më dukshëm vjen në shprehje përdorimi jokompetent dhe i pavend i precedentëve të Strasburgut nga **Gjykata Kushtetuese**. Këta precedentë, siç do të provohet në vijim, në fakt, fare nuk kanë të bëjnë dhe nuk mund të gjejnë aplikim në rastin e shpallur si të papranueshëm **ratione materiae** nga kjo Gjykatë. Të shohim në vijim si duket kjo.

Që në fillim theksojmë se ky precedent ka pasur të bëjë me ekzekutimin e një vendimi meritor të **Gjykatës së Strasburgut** në **Principatën e Lihtenshtajnit** (e cila kishte humbur rastin kundër shtetasit te saj), pra me jo ekzekutim të vendimit të një gjykate nacionale të një shteti anëtar të Konventës.

Parashtruesit në këtë rast kanë kërkuar nga qeveria e **Lihtenshtajnit** kompensim për shkak të caktimit të tokës së tyre (parcelës së caktuar), si pronë në të cilën nuk mund të ndërtohet. Kjo ka ndodhur më 15 korrik 1997. Këtë kërkesë e ka refuzuar qeveria e **Lihtenshtajnit** më 2 qershor 1998. Ky vendim qeveritar është apeluar në **Gjykatën Administrative**. Në këtë procedurë, e cila është mbyllur me vendimin refuzues të datës 25 qershor 1999, si ndërhyrës është paraqitur komuna në të cilën ka qenë parcela e shpronësuar. Në një parashtresë të arsyetuar gjerësisht, kjo komunë ka kërkuar që **Gjykata Administrative** ta refuzojë kërkesën e tyre për kompensim. Kjo kërkesë është miratuar. Vendimi **Gjykatës Administrative** është bazuar në shkresat e lëndës, duke mos ia komunikuar fare kërkuesve parashtresën e komunës që ka ndërhyrë si palë e tretë në këtë proces. **Gjykata Administrative** këtë e ka arsyetuar me faktin se parashtresa fare nuk ka ndikuar në vendimin e saj meqë çdo gjë ka qenë e qartë në baza të shkresave ekzistuese të lëndës.

Një përgjigje të ngjashme refuzuese, parashtruesit e kishin marrë edhe nga **Gjykata Kushtetuese e Lihtenshtajnit**: në vendimin e saj lidhur me ankesën kushtetuese të palëve, kjo Gjykatë kishte konstatuar se moskomunikimi i palëve të parashtresës së komunës së involvuar ku gjendej prona e kërkuesve nuk ka cenuar të drejtën e tyre për gjykim të drejtë për shkak se, përkundër faktit që parashtresa ka përmbajtur informata të reja, ajo nuk ka pasur asnjë ndikim në vendimmarrjen e **Gjykatës Administrative.**[217]

Pas kësaj, çështja kishte mbërritur në Strasburg përmes aplikacionit të datës 12 tetor 2000. Me vendimin e vet të datës 19 maj 2005, **Gjykata e Strasburgut** ka konstatuar se kishte pasur cenim të nenit 6.1 të Konventës pikërisht për shkak se palave në procedurë, kërkuesve, nuk iu ishte dhënë mundësia për të komentuar parashtresën e komunës ku gjendej prona e tyre objekt kontesti. Në mënyrë shumë të saktë profesionale, Strasburgu ka vërejtur se kjo mangësi e vendimmarrjes nacionale nuk ishte adresuar si duhet nga gjykatat e **Lihtenshtajnit**. Si e tillë, sipas vlerësimit të Strasburgut, ajo nuk ka mund të eliminohet vetëm për faktin se palët kanë pasur të drejtë në ankesë kushtetuese, ngaqë **Gjykata Kushtetuese e Lihtenshtajnit** nuk bën rishqyrtimin e tërësishëm faktik dhe juridik të rasteve.[218] Kjo, në thelb, është kështu edhe në Kosovë dhe në çdo gjykatë kushtetuese ku ka **ankesë të plotë dhe gjysmë të plotë kushtetuese** sepse, sipas parimit të subsidiaritetit, gjykatat kushtetuese kujdesen vetëm për eliminimin e shkeljeve të natyrës kushtetuese pa hyrë në vlerësimin e fakteve dhe cilësimeve juridike të bëra nga ana e gjykatave nacionale dhe autoriteteve të tjera që merren me çështjet e interpretimit të ligjeve me qëllim të zbatimit.

Siç mund të vërehet, **parimi i subsidiaritetit** këtu ka kuptim tjetër nga parimi i subsidiaritetit të gjykatave nacionale kundrejt **Gjykatës së Strasburgut**. Në rastin e fundit, ai parim derivohet nga Konventa dhe ka të bëjë me shtete nacionale. Sipas tij, shtetet anëtare zotohen për vënien në jetë të

---

[217] ***Steck-Risch dhe të tjerët kundër Lihtenshtajnit* (dec), nr. 29061/08, 11 maj 2010.** *2. The proceedings in the case of* Steck-Risch and Others v. Liechtenstein*, application no. 63151/00* **a. The proceedings before the domestic courts.**

[218] ***Steck-Risch dhe të tjeret kundër Lihtenshtajnit* (dec), nr. 29061/08, 11 maj 2010.** *2. The proceedings in the case of* Steck-Risch and Others v. Liechtenstein*, application no. 63151/00.* **b. The proceedings before this Court.**

Konventës dhe standardet e saj të ndërtuara nga **Gjykata e Strasburgut**, rrethanë që nuk është prezent në nivel nacional sepse nuk ka zotim të gjykatave të rregullta për zbatim të kushtetutës nacionale, por vetëm detyrim kushtetues për një gjë të tillë.

Gjykata e Strasburgut kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën për satisfaksion të drejtë sipas nenit 46 të Konventës për shkak se nuk kishte gjetur lidhje kauzale në mes të shkeljes së nenit 6.1 dhe kompensimit të drejtë sipas nenit 41 të Konventës. Palët kishin dështuar të provonin se shkelja e nenit 6.1 të Konventës ka rezultuar në një dëm të konsiderueshëm që mund të futej nën kornizat e nenit 41 të Konventës. E thënë me fjalë të tjera, Strasburgu këtu nuk ka gjetur asnjë lidhje kauzale në mes të garancioneve procedurale nga neni 6.1 i Konventës dhe një të drejte materiale nga neni 41 i saj.

Ishte refuzuar dhe kërkesa e palëve për **përsëritje të procedurës** për shkak se shtetet anëtare plotësojnë detyrimet sipas vendimeve të **Gjykatës së Strasburgut** në mënyrë diskrecionale dhe të mëvetësishme. Përveç rasteve të rralla kur vetë **Gjykata e Strasburgut** me vendim të vet cakton mënyrën e zbatimit (ekzekutimit) të vendimit të saj, në të gjitha rastet tjera, konform nenit 46 të Konventës, vetë shtetet anëtare kanë marrë zotim se do të gjejnë mënyrat përkatëse për të vënë në jetë vendimet e saj. Për rastet kur Strasburgu bën një gjë të tillë, pra kur vet i cakton modalitetet e ekzekutimit (zbatimit) të vendimit të saj, në këtë precedent është cituar rasti i njohur ***Assanidze v Georgia*** (2004),[219] përkatësisht paragrafët 200-202 të aktgjykimit për këtë rast. Për rastin që diskutojmë këtu kanë rëndësi më të madhe paragrafët 198-201 të rastit në fjalë: në këta dy paragrafë, **Gjykata e Strasburgut** ka theksuar se është detyrë e shteteve anëtare që të ndërpresin cenimin e Konventës në mënyrë të menjëhershme dhe t'u ofrojnë palëve një kompensim të drejtë, pa marrë parasysh që rendi i brendshëm juridik mund të mos parashikoj një gjë të tillë. Kjo është kështu, gjithnjë sipas vlerësimit të Strasburgut, për shkak se synim duhet të jetë që sa më shumë të rikthehet gjendja ashtu siç ka qenë para cenimit të Konventës. Në kuadër të masave për të arritur një gjë të tillë, sipas këtij precedenti, shtetet anëtare zotohen për të harmonizuar rendet e tyre juridike me rendin e ndërtuar sipas zotimeve dhe standardeve të Konventës. Kjo është kështu, sipas përcaktimit të shprehur në paragrafin 202 të precedentit si më sipër, si pasojë e faktit që vendimet e Strasburgut janë të natyrës deklarative ashtu që ngelet që vetë shtetet anëtare të Konventës të ndërmarrin krejt masat e nevojshme për të siguruar liritë dhe të drejtat nga Konventa.

Në po këtë paragraf, **Gjykata e Strasburgut** ka thënë se kjo gjendje rrjedh nga diskrecioni i shteteve konform parimit të barazisë sovrane që përkthehet në parimin e vlerësimit të lirë nga ana e tyre të mënyrave për vënie në jetë të detyrimeve që dalin nga vendimet e Strasburgut. Sikundër shihet këtu vlerësimi i lirë nuk ka të bëjë me gjykata nacionale por me shtetet sovrane që janë anëtarë të Konventës. Kjo lidhet drejtpërdrejtë me masat diskrecionale që shtetet i synojnë dhe marrin me qëllim ndërprerjen e cenimeve të një të drejte dhe ofrimin e satisfaksionit të drejtë ashtu siç e ka përcaktuar me vendim **Gjykata e Strasburgut.**

Tani i kthehemi sërish rastit, të cilin **Gjykata Kushtetuese** e ka marrë si precedent.

Pasi kishin fituar rastin në **Strasburg**, palët u janë drejtuar autoriteteve vendore, këtë herë me kërkesë për të rihapur (përsëritur) procedurat e mbyllura për kompensim të dëmit, bazuar në vendimin e **Gjykatës së Strasburgut** që gjente shkelje të nenit 6.1 të Konventës. Ata kishin besuar se **Lihtenshtajni** kishte detyrim për rihapjen e procedurave. Një kërkesë e tillë ishte refuzuar, fillimisht nga **Gjykata Administrative**, si gjykatë me juridiksion origjinal në çështjen në fjalë, pastaj edhe nga **Gjykata Kushtetuese e Lihtenshtajnit**, e cila kishte theksuar se cenimi i nenit 6.1. të Konventës nuk nënkuptonte që shtetet nacionale duhet të rihapnin procedurat e mëhershme në të cilat Strasburgu kishte gjetur shekja e nenit 6.1 të Konventës. **Gjykata Administrative** kishte thënë se rihapja e procedurave nuk parashikohej me legjislacionin e brendshëm për procedurat administrative në rastet kur Strasburgu gjen shkelje të Konventës, në këtë rast të nenit të saj 6.1.

---

[219] **COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS.** ***CASE OF ASSANIDZE v. GEORGIA*** *(Application no. 71503/01).* ***JUDGMENT***. STRASBOURG 8 April 2004.

Këtë herë, me rastin e kontrollit kushtetues të vendimit të **Gjykatës Administrative**, **Gjykata Kushtetuese** kishte thënë se ky konstatim i saj jo vetëm që nuk ishte arbitrar, për dallim nga hera e parë, por edhe se bëhej fjalë për një gjendje krejtësisht të re që nuk kuptohej nga parashtruesi i kërkesës për përsëritje të procdurës. Sipas Gjykatës Kushtetuese, konstatimi i Strasburgut për cenim të nenit 6.1 të Konventës nuk përbën fakt apo provë të re mbi bazën e të cilës mund të rihapet procedura sipas legjislacionit vendor, por vlerësim juridik të ri të rastit. Kjo nënkuptonte që konstatimi i shkeljes së nenit 6.1 të Konventës ka qenë një satisfaksion të mjaftueshëm për palën, në kuptim të nenit 41 të Konventës. Përtej kësaj, i njëjti nuk mund të përdoret për qëllime të tjera, në veçanti si fakt apo provë e re. Këto janë konstatime të **Gjykatës Kushtetuese të Lihtenshtajnit** lidhur me rihapjen e procedurës mbi bazën e konstatimeve të Strasburgut që gjejnë shkelje të nenit 6.1 të Konventës.

Gjykata e Strasburgut, në këtë precedent më tej thekson se vetë ajo do të kishte dhënë urdhër për një formë tjetër të kompensimit të drejtë sipas nenit 41 të Konventës vetëm nëse një gjë e tillë do të kishte qenë e domosdoshme për të adresuar thelbin e kërkesës. Kjo, më tutje, nënkuptonte, gjithnjë sipas vlerësimit të Strasburgut, se shtetet anëtare duhet të vendosin për modalitetet e rihapjes së procedurave në rastet kur **Gjykata e Strasburgut** konstaton cenim të Konventës, siç bëjnë disa shtete, si p.sh.: **Austria**, **Gjermania** dhe **Zvicra**, ku përsëritja e procedurës lejohet ligjërisht pas çdo vendimi që gjen shkelje të normave të Konventës dhe standardeve të vëna nga Strasburgu.

Përcaktimi i modaliteteve të mënyrës së ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës së Strasburgut është detyrë e shtetit, jo e gjykatave nacionale (të rregullta apo kushtetuese), konstaton vendimi për këtë rast.[220] Atëherë, pyetja e cila shtrohet këtu është se kush duhet të kujdeset për zbatimin e vendimeve të Strasburgut? Këtë pyetje ia kishin parashtruar kërkuesit **Gjykatës Kushtetuese në Lihtenshtajn**, për ta përsëritur të njëjtën edhe në **Gjykatën e Strasburgut.**[221] Përgjigja e kësaj të fundit u dha me vendimin e saj që diskutohet këtu. Në te theksohej se për ekzekutimin e vendimeve të Strasburgut kujdeset **Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës** (më tej shkurt: "Komiteti Ministrave" ose vetëm "Komiteti"), detyrim ky konform nenit 46 të Konventës. Me këtë rast u theksua se vendimet e **Gjykatës së Strasburgut** kanë natyrë kryesisht deklarative. Këtë rrethanë e ka konstatuar edhe Komiteti përmes rezolutës së vet të datës 20 dhjetor 2006. Kjo nënkuptonte që ekzekutimi i vendimeve ishte jashtë ingerencave të **Gjykatës së Strasburgut**, ani se mënyra dhe modalitetet e këtij ekzekutimi përcaktohen nga vetë ajo. Kjo nuk ndryshon asgjë që në konstatimin tonë më sipër se çdoherë u lihet shteteve anëtare mundësia për të rregulluar mënyrat dhe masat për vënien në jetë të vendimeve të Strasburgut, përfshirë këtu rastet kur përsëritja e procedurës shihet si mënyrë e ofrimit të satisfakcionit të drejtë sipas nenit 41 të Konventës.[222] E thënë me fjalë të tjera, në rastin konkret, vendimi i **Gjykatës së Strasburgut** që konstatonte shkelje të nenit 6.1 të Konventës, nuk nënkuptonte se autoritetet e **Lihtenshtajnit** detyroheshin të rihapnin procedurat e mbyllura nëse një gjë e tillë nuk parashikohej me legjislacionin e brendshëm të këtij vendi, siç kishte qenë rasti në fjalë.

Në vijim si më sipër, **Gjykata e Strasburgut** kishte konstatuar se ishte e papranueshme **ratione materiae** kërkesa e palëve për përsëritje të procedurës duke u bazuar në vendimin e **Gjykatës së Strasburgut** mbi cenimin e nenit 6.1 të Konventës të datës 19 maj 2005 (i cituar më lartë). Kjo papranueshmëri u bazua në dy arsye. Në rend të parë, kërkuesit në procedurën e dytë të nisur në Strasburg nuk ankohen për

---

220 ***Steck-Risch dhe të tjerët kundër Lihtenshtajnit* (dec), nr. 29061/08, 11 maj 2010.** *2. The proceedings in the case of* Steck-Risch and Others v. Liechtenstein*, application no. 63151/00. 3. The proceedings at issue:* **a. The proceedings instituted before the Administrative Court.** *i. Proceedings before the Administrative Court & ii. Proceedings before the Constitutional Court.*

221 ***Steck-Risch dhe të tjerët kundër Lihtenshtajnit* (dec), nr. 29061/08, 11 maj 2010.** *2. The proceedings in the case of* Steck-Risch and Others v. Liechtenstein*, application no. 63151/00. The proceedings at issue:* **a. The proceedings instituted before the Administrative Court.** *i. Proceedings before the Administrative Court & ii. Proceedings before the Constitutional Court.* **b. The proceedings instituted directly before the Constitutional Court.**

222 ***Steck-Risch dhe të tjerët kundër Lihtenshtajnit* (dec), nr. 29061/08, 11 maj 2010.** *2. The proceedings in the case of* Steck-Risch and Others v. Liechtenstein*, application no. 63151/00. 3. The proceedings at issue. 4. The Resolution of the Committee of Ministers of the Council of Europe.* "... **Individual measures; … General measures.**

cenim të nenit 6.1 të Konventës në kuptim të asaj që gjykimi ka qenë i padrejtë dhe i paanshëm, por për atë se organet vendore, **Gjykata Administrative** dhe **Gjykata Kushtetuese në Lihtenshtajn**, nuk kanë rihapur procedurat mbi bazën e shkeljes së konstatuar në Strasburg të neni 6.1 të Konventës me vendimin e sipërcituar të datës 19 maj 2005. Kjo është kështu sepse neni 6.1 i Konventës gjen zbatim vetëm në procedurat e përfunduara me vendim të formës së prerë dhe jo në ato që fare nuk kanë ndodhur dhe nuk kanë statusin e gjykimit.

Si arsye e dytë për papranueshmëri në këtë rast ka shërbyer fakti që mbikëqyrja e ekzekutimit të vendimeve të Strasburgut i takon **Komitetit të Ministrave**, jo autorit të vendimeve. Kjo, megjithatë, nuk do të thotë se procedura e ekzekutimit dhe sjellja e shteteve përgjegjëse kundrejt vendimeve të **Gjykatës së Strasburgut** që gjejnë shkelje dhe ekzekutimit të tyre nuk mund të prodhojnë çështje të tjera që mund të jenë objekt i kërkesave të reja për **Gjykatën e Strasburgut**. Kjo, sipas Strasburgut, mund të ndodhë vetëm nëse bëhet fjalë për fakte dhe prova të reja, siç kishte qenë një rast kundër **Zvicrës** ku **Gjykata e Strasburgut** kishte gjetur shkelje të nenit 10 të Konventës. Në këtë rast, i njohur si rasti *Verein gegen Tierfabriken Schweiz (VgT)* (2009), autoritetet zvicerane nuk kishin mundësuar rihapjen e procedurave, siç kishte kërkuar vendimi origjinal i **Gjykatës së Strasburgut**, me qëllim që pala të arrinte satisfakcionin e plotë duke rishpallur reklamën e vet të ndaluar nga autoritete zvicerane. Ky nuk ishte rasti, sipas arsyetimit të Strasburgut, në rastin e **Lihteshtajnit** që diskutojmë këtu: kërkesa për përsëritjen e procedurës në këtë vend nuk parashikohej si mënyrë për adresimin e cenimeve të Konventës. **Shteti i Lihtenshtajnit**, me një fjalë, nuk ishte zotuar se do të rihapte procedurat e mbyllura me vendim të formës së prerë në ato raste kur Strasburgu do të konstatonte cenim të nenit 6.1 të Konventës, siç kishin bërë disa vende që u cituan më sipër (**Austria**, **Gjermania** dhe **Zvicra**).

Rihapja e procedurave si pasojë e cenimit të Konventës, me qëllim të adresimit të vendimeve të **Gjykatës së Strasburgut** që gjejnë shkelje të nenit 6.1 të Konventës, përbën një ndër rekomandimet e Komitetit, me të cilin fuqishëm ishte pajtuar edhe vetë **Gjykata e Strasburgut** në vendimin e sipërcekur kundër **Lithenshtajn**-it. Në faqen 12 të vendimit, Strasburgu kishte theksuar në mënyrë shprehimore, **inter alia**, për sa vijon:[223]

"[...] Gjykata lidhur me këtë çështje në tërësi pajtohet me Rekomandimin No. R (2000) 2, miratuar nga Komiteti i Ministrave, ku shtetet anëtare të Konventës ftohen për të siguruar dhe ofruar mundësi të përshtatshme për rihapjen e procedurave në nivel vendor çdoherë kur Gjykata ka gjetur cenimet e Konventës. Komiteti konfirmon që masat e tilla për ekzekutim të vendimeve të GJEDNJ përfaqësojnë "mënyrën më efektive, nëse jo të vetmen, për arritjen e ***restitutio in integrum***" (shih ***Verein gegen Tierfabriken Schweiz (VgT) (no. 2)***, cituar më sipër, §§ 33 dhe 89, dhe "Praktika relevante vendore dhe nga e drejta ndërkombëtare", si më sipër)."

Kjo që u tha deri këtu lidhur me këtë rast, besojmë se ia bën lexuesit të qartë se **Gjykata Kushtetuese** ka gabuar rënd kur ka interpretuar në mënyrë arbitrare praktikën e **Gjykatës së Strasburgut**, duke vënë veten në pozitën e saj në raport me gjykatat e rregullta sa i përket kontrollit kushtetues të vendimeve të këtyre të fundit. Zbatimi i nenit 53 të Kushtetutës, që sanksionon precedentët e Strasburgut si burim formal të së drejtë kushtetuese në sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut, paraqet një çështje krejtësisht tjetër nga substituimi (zëvendësimi) i **Gjykatës Kushtetuese** në vend të **Gjykatës së Strasburgut**. Si pasojë e këtij substituimi (zëvendësimi) arbitrar nga ana e Gjykatës Kushtetuese del edhe gabimi tjetër, ai i ngatërrimit të zotimeve që ka shteti i **Kosovës** ndaj Konventës me detyrimin kushtetues nga neni 53 i Kushtetutës, që detyron **Gjykatën Kushtetuese** dhe çdo autoritet tjetër publik për të vënë në jetë jurisprudencën e **Gjykatës së Strasburgut**. Ajo jurisprudencë, siç e kemi parë, ka të bëjë me krijimin e standardeve minimale të cilat shtetet anëtare duhet t'i vejnë në jetë në sferën e lirive dhe të drejtave të garantuara me Konventë. Me standard minimal, siç u pa edhe nga rekomandimi i Komitetit e me të

[223] ***Steck-Risch dhe të tjerët kundër Lihtenshtajnit* (dec), nr. 29061/08, 11 maj 2010.** *2. The proceedings in the case of* Steck-Risch and Others v. Liechtenstein*, application no. 63151/00.* **COMPLAINT: THE LAW**.

cilin në tërësi pajtohet Gjykata Strasburgut në rastin e **Lihtenshtjanit,** nënkuptohet lejimi i rihapjeve të procedurave të mbyllura me vendim të formës së prerë çdoherë kur Strasburgu gjen një cenim të nenit 6.1 të Konventës.

Në rastin e **Lihtenshtajnit**, të cilin **Gjykata Kushtetuese** e ka marr si bazë për vendosje, fare nuk bëhet fjalë për kërkesë për përsëritje të procedurës për shkak të gjetjes së cenimit të Konventës së konstatuar nga Strasburgu, por për ankesë të re kushtetuese me të cilën parashtruesit kosovar kanë pretenduar se iu janë shkelur të drejtat e tyre kushtetuese nga neni 31 i Kushtetutës. Kualifikimi juridik i palës këtu fare nuk ka rëndësi, sepse gjatë kontrollit kushtetues të vendimeve të autoriteteve publike sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, **Gjykata Kushtetuese** ka për detyrë të vlerësoj kushtetutshmërinë e vendimit individual që kontestohet marrë në tërësinë e tij, pa marr parasysh çfarë thotë pala. Kjo është kështu edhe për faktin se përfaqësimi me avokat në **Gjykatën Kushtetuese** nuk është i detyrueshëm, siç nuk është i tillë në shumicën e vendeve të Evropës.

Në të njëjtën kohë, Kosova nuk është anëtarë i **Këshillit të Evropës** (më tej shkurt "KE") dhe nuk ka asnjë detyrim për të nxjerrë legjislacion implementues të zotimeve nga Konventa, siç kanë bërë **Austria**, **Gjermania** dhe **Zvicra** dhe një numër i madh i vendeve ish-komuniste, legjislacion që do të detyronte rihapjen e procedurave gjyqësore të mbyllura me vendim të formës së prerë në rastet kur konstatohet një shkelje e Konventës, e nenit 6.1 të saj. Kjo për arsye të thjeshtë se ato vendime nuk janë fare kundër Kosovës. Në të vërtetë, asnjë vendim i Strasburgut nuk mund të ketë efekt **inter partes** ndaj Kosovës. Si parim, u tha më sipër, vendimet e **Gjykatës së Strasburgut** edhe ashtu kanë, marrë në tërësinë e tyre, **karakter deklarativ**. Ato deklarojnë një cenim ose jo të Konventës dhe, për pasojë, një cenim të zotimeve të shteteve anëtare që kanë marrë me rastin e hyrjes në Konventë. Nëse kjo është kështu, e sigurisht që e tillë është, atëherë duhet thënë se jurisprudenca e Strasburgut që ka karakter deklarativ duhet të interpretohet me qëllim ekskluziv për t'i siguruar në Kosovë standardet minimale në sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut, dhe jo të bëhet cenimi i tyre në instancën e fundit të drejtësisë në Kosovë, në **Gjykatën Kushtetuese.**

Kjo nënkupton se vendimet individuale të autoriteteve publike në Kosovën e pavarur dhe sovrane nuk mund të përjashtohen nga kontrolli kushtetues me arsyetimin se janë **ratione materiae** jashtë juridiksionit të **Gjykatës Kushtetuese**. Neni 113.7 i Kushtetutës është i qartë: ai përfshinë çdo vendim të karakterit individual të autoriteteve publike në Kosovë. Neni 53 i Kushtetutës, ndërkaq, shërben si dispozitë ku ankorohet burimi kryesor i të drejtës kushtetuese kosovare me karakter precedenti dhe, si çdo burim tjetër, duhet të interpretohet para zbatimit (implementimit) të tij në një rast apo mosmarrëveshje konkrete. Ai zbatim (implementim) i precedentit në një rast apo mosmarrëveshje konkrete nënkupton subsumimin (nën vënien) nga ana e Gjykatës Kushtetuese të gjendjes së konkrete faktike që formon një rast apo mosmarrëveshje kushtetuese nën standardet e vendosura nga precedentet e Strasburgut. Ky detyrim kushtetutës shtrihet, **mutatis mutandis**, edhe ndaj çdo autoteriteti tjetër publik që vendos për liritë dhe të drejtat e njeriut në territorin e Kosovës. Kjo nënkupton, e thënë me fjalë të tjera, se **Gjykata Kushtetuese** dhe çdo autoritet tjetër publik në Kosovë ka për detyrim që secilën situatë konkrete që përmban një rast apo mosmarrëveshje të natyrës kushtetuese ta interpretoj sipas standardeve të vëna me vendimet e Strasburgut. Kjo në asnjë rast dhe në asnjë mënyrë nuk do të thotë dhe nuk nënkupton që **Gjykata Kushtetuese** dhe autoritetet tjera publike në **Kosovë** mund të substituohen (zëvendësohen) në vend të **Gjykatës së Strasburgut** sepse marrëdhëniet e saj në domenin e të drejtës së brendshme nuk janë marrëdhënie sovraniteti, siç janë ato të **Strasburgut** kundrejt shteteve të tjera anëtare të Konventës: roli dhe pozita e **Gjykatës Kushtetuese** nuk përcaktohet me Konventë por me Kushtetutë, në veçanti me dispozitat e saj të neneve 4 dhe 112–118.

Për t'u kthyer sërish te lëshimet e **Gjykatës Kushtetuese**, në rastin e cilësuar nga ky organ kosovar si përsëritje e procedurës, kjo si më sipër nënkupton në veçanti tri gjëra: e para, se **Gjykata Kushtetuese** mund të mohojë juridiksionin **ratione materiae** në çështjet e përsëritjes së procedurës vetëm nëse një gjë e tillë thuhet shprehimisht në Kushtetutë, në dispozitat që normojnë juridiksionin e saj kushtetues;

e dyta, e kundër me këtë, se **Gjykata Kushtetuese** detyrohet të urdhëroj përsëritjen e procedurave të mbyllura me vendim të formës së prerë vetëm atëherë kur kjo përbën detyrim ndërkombëtar të Kosovës për prishjen e vendimeve nacionale çdoherë kur Strasburgu gjen shkelje të dispozitave të Konventës, pra në rastet që kanë të bëjnë me **Kosovën**; dhe, së fundi, meqë asnjëra nga situatat e sipërme nuk mund të vlejë për **Kosovën**, atëherë nuk ka rrugë tjetër pos asaj që **Gjykata Kushtetuese** çdoherë të vlerësoj kushtetutshmërinë e vendimeve refuzuese për përsëritje të procedurës, por jo duke shpallur rastin të papranueshëm **ratione materiae** përmes përdorimit të precedentëve të Strasburgut në mënyrë jo kritike dhe pa vend. Në rastet kur kërkohet vlerësimi kushtetutshmërisë kundrejt garancie procedurale nga neni 31 i Kushtetutës, **Gjykata Kushtetuese** çdoherë duhet të shikoj nëse vendimi i marrë, në tërësinë e tij, është i përlyer me cenime kushtetuese të cilësdo natyrë, siç vepron në rastet tjera.

Kjo nuk do të thotë se **Gjykata Kushtetuese** rastet e kërkesave që tërthorazi kanë të bëjnë me përsëritjen e procedurës nuk mund t'i shpall si papranueshme **ratione materiae**. Ajo mund ta bëjë një gjë të tillë por duke vlerësuar papranueshmërinë kundrejt situatës faktike pa u thirrur në precedentin e Strasburgut që përcakton standardet minimale në materien e përsëritjes së procedurës, si dhe duke mos e luajtur rolin e një gjykate ndërkombëtare. Një situatë e tillë do të ishte, ta zëmë, sikur rasti apo mosmarrëveshja e vendosur të kishte karakter jo-kushtetues, përkatësisht karakter të një vendimi të nxjerrë nga një organ në ushtrim të autorizimeve **iure imperi**, jo të atyre autorizimeve që kanë natyrë **iure gestionis**. I tillë ka qenë, ta zëmë, rasti i **Feronikelit**,[224] rast në të cilin **Gjykata Kushtetuese** ka dështuar të ndërtoj precedent ku do të mund të mbështetej në të ardhmen. Objekt kontrolli kushtetues ka qenë vendimi i një kompanie private për ndërprerje të marrëdhënies së punës të një punëtori. Gjykata ka vendosur se rasti është i palejueshëm jo **ratione materiae**, por për shkak të mosshterjes së mjeteve juridike (sic!).[225] Jo vetëm kaq! Gjyqtarët që nuk u pajtuan me mosshterjen e mjeteve juridike si shkak për papranueshmëri, nuk thanë që bëhej fjalë për një rast të qarta të mungesës nga ana e Gjykatës të juridiksionit **ratione materiae**, por për papranueshmëri **ratione materiae**.[226] Vështirë se mund të kuptohet çfarë ka të bëjë këtu **ratione materiae** si shkak për papranueshmëri.

16.13.4.Precedenti i katërt: *Nistler kundër Austrisë,* nr. 24912/08, Vendim i 19 nëntorit 2013

Në këtë rast bëhet fjalë për kërkesë për përsëritje të një pjese të procedurës në një rast civil (**restitutio in integrum**), pra për përsëritjen vetëm të një veprimi të pa ndërmarrë procedural me të cilin kishte përfunduar procedura për shkak të mungesës së palës, por pa fajin e saj.[227] Këtu, pra, bëhet fjalë për një rast të vendosur në nivel nacional, por jo të përfunduar me vendim të formës së prerë, përkatësisht nuk bëhet

---

224 *Rasti KI 178/18. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Bujar Hoti. Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës së 1 marsit 2013*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 27 mars 2019 Nr. ref.: RK 1330/19.

225 Si precedent për të mbështetur këtë qëndrim të vetin, Gjykata ka përdorur një rast penal, rastin **KI 07/09**, *Demë dhe Besnik Kurbogaj,* të 19 majit 2010, paragrafët e tij 28-29. Këtë e ka bërë në paragrafin 27 të Aktvendimit, në të cilin thuhet: "Gjykata konkludon, se parashtruesi i kërkesës në rastin konkret ka hequr dore nga e drejta e tij për ta shfrytëzuar mjetin juridik, i cili në pajtim me ligjin e zbatueshëm ishte në dispozicion të tij, prandaj, konkludohet se ai nuk i kishte shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj (shih: rasti i Gjykatës Kushtetuese **KI 07/09**, *Demë dhe Besnik Kurbogaj,* 19 maj 2010, paragrafët 28-29)·"
Ky citim po ashtu është krejtësisht arbitrar për dy arsye: e para, se këta dy paragrafë të këtij rasti fare nuk kanë të bëjnë me mosshterje të mjeteve juridike në kuptimin formal, por për mosngritje nga ana e parashtruesit të disa çështjeve kushtetuese gjatë procedurave penale kundër tij (sic!); dhe, e dyta, se në këtë precedent fjala ka qenë për procedura të zhvilluara para organeve shtetërore, ku parashtruesi ka lëshuar ndërmarrjen e disa hapave në dobi të tij. Në rastin e **Feronikelit**, ndërkaq, bëhet fjalë për një vendim të marr në një procedurë ku marrëdhëniet janë të natyrës tërësisht private (**iure gestionis**), nga një kompani që nuk ushtron autorizime publike. Mosshterja e mjeteve juridike si shkak për papranueshmëri në këtë rast nuk ka asnjë kuptim dhe logjikë.

226 Paragrafi 9 i Aktvendimit në rastin **KI 178/18**. Pyetja që shtrohet këtu është kjo: çfarë ndodhë kur pala t'i ketë shterur mjetet juridike pas një kohe? A nuk është ky vendim mesazh për palën se rasti i tij do të jetë i pranueshëm pasi t'i ketë shterur mjetet juridike?!

227 "[…] 19. The Court notes that the main issue of the present application is the applicability of Article 6 of the Convention to proceedingsconcerning the reinstatement of a party in civil proceedings.". **COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS.** FIRST SECTION DECISION Application no. 24912/08. *Johann NISTLER against Austria*. Në internet: https://sip.lex.pl/orzeczenia-i-pisma-urzedowe/orzeczenia-sadow/24912-08-nistler-v-austria-decyzja-europejskiego521 490408 (shikuar në janar 2020).

fjalë për kërkesë të palës për përsëritje të procedurës së mbyllur me vendim të formës së prerë duke u bazuar në një vendim pozitiv të **Gjykatës së Strasburgut** që gjen shkelje të nenit 6.1 të **Konventës** (siç ishte rasti si më sipër). Rasti është shpallur i papranueshëm nga ana e **Strasburgut** në fazën fillestare bazuar në nenin 35 para. 3 (a) dhe 4 të **Konventës** (fjalia e parë e dispozitës që normon shpalljen e papranueshme të një kërkese si pasojë e papajtueshmërisë **ratione materiae** me dispozitat e Konventës).

Ky rast edhe më dukshëm shpërfaq jo kompetencën e **Gjykatës Kushtetuese** me rastin e ushtrimit të juridiksionit të saj nga neni 113.7 i Kushtetutës. Kjo është kështu për dy arsye: *e para*, sepse bëhet fjalë për rastin kur kërkesa për përsëritje të pjesës së caktuar të procedurës, e mbështetur në nenin 6.1 të Konventës, është bërë dhe vendosur brenda instancave gjyqësore të **Austrisë**; dhe, *e dyta*, sepse në arsyetimin e vendimit refuzues të kërkesës së aplikuesit, **Gjykata e Strasburgut** ka treguar se jo çdoherë dhe jo në të gjitha rastet mund të përdoret **ratione materiae** si shkak për papranueshmëri të kërkesës.

Sa i përket çështjes së parë, natyrës së vendimit të kontestuar, **Gjykata e Strasburgut** ka theksuar se këtu fjala ka qenë për një vendim interlokutor (të ndërmjetëm), me objekt kërkesën për rikthim në gjendje të mëparshme të procedurës për shkak të lëshimit të palës për të qenë prezent në seancë. Lidhur me këto lloje të vendimeve, **Strasburgu** ka gjetur se jo çdoherë mund të përjashtohet zbatimi i nenit 6 të Konventës ndaj tyre për shkak se edhe në fazat e ndërmjetme të procedurës mund të vendoset për të drejtat civile të palëve në kuptim të nenit 6 të Konventës. Si precedentë për këtë ka marrë disa raste lidhur me masat e përkohshme, lidhur me pezullimin e procedurave gjyqësore, si dhe lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Si një shembull ka marr një rast të vendosur në **Serbi**, mirëpo në të cilin ka gjetur se vendimi interlokutor (ndërmjetëm) për rikthim në gjendjen e mëparshme ka pasur efekt të drejtpërdrejt në liritë dhe të drejtat civile të palës, e cila më pastaj ka fituar rastin në **Gjykatën e Strasburgut** pikërisht mbi bazën e shkeljes së nenit 6.1 të Konventës.[228] Për këtë arsye, **Strasburgu** ka theksuar se jo në të gjitha rastet e vendimeve procedurale nuk gjen zbatim nenin 6.1 Konventës: nuk janë vendimet e natyrës procedurale ato që përcaktojnë zbatimin ose jo të nenit 6.1 të Konventës, por fakti nëse me to vendoset mbi të drejtat civile të palëve, pa marrë parasysh se vendimet në fjalë nuk kanë natyrë të vendimit meritor. Kjo nënkupton, gjithnjë sipas **Gjykatës së Strasburgut**, se objekti dhe qëllimi i disa vendimeve procedurale, siç janë ato lidhur me vënien e masës së përkohshme, pezullimin e procedurës, ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe të ngjashme, në disa raste kanë efekte të drejtpërdrejta në të drejtat civile në kuptim të nenit 6.1 të Konventës.[229]

Menjëherë pas kësaj, **Gjykata e Strasburgut** është kthyer në trajtimin e situatave të zbatimit të nenit 6 të Konventës kur ato kanë të bëjnë me vendimet e formës së prerë me të cilat është vendosur lidhur me të drejtat civile në kuptim të nenit 6 të Konventës. Në këto raste, **Strasburgu** ka theksuar se mund të ekzistojnë dy faza: faza e parë dhe faza e dytë. Në të parën, gjykata përkatëse vlerëson nëse ekzistojnë zhvillime të reja që arsyetojnë rihapjen e procedurave të mbyllura me vendim të formës së prerë. Kjo do të thotë se **Gjykata e Strasburgut** i referohet secilit sistem juridik evropian dhe çdo procedure gjyqësore që ka vendosur lidhur me të drejtat civile të qytetarëve në kuptim të nenit 6 të Konventës, gjë që shihet nga precedentët që i citon me këtë rast.[230] Në fazën e dytë, nëse gjykata e dhënë vendore ka vlerësuar se ekzistojnë kushtet për rihapje të procedurave të përfunduara me vendim të formës së prerë, atëherë në tërësi vlejnë standardet e nenit 6 të Konventës në procedurat e reja të rihapura sepse këtu vendoset sërish lidhur me të drejtat civile në kuptim të këtij neni.

Pas këtij konstatimi, **Gjykata e Strasburgut** vjen deri te një konstatim tjetër jashtëzakonisht i rëndësishëm, të cilin **Gjykata Kushtetuese** në tërësi e ka injoruar. Këtu, në të njëjtin paragraf, në paragrafin 22 të vendimit, **Strasburgu** vjen deri te konkludimi, *inter alia*, që thotë si vijon:

---

228 Cf. **COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS.** FIRST SECTION DECISION Application no. 24912/08. *Johann NISTLER against Austria*, paragrafi 23.

229 Ibid., paragrafët 20-21 & 24.

230 Ibid., paragrafi 21.

"[...] Gjykata, megjithatë, ka pranuar se në raste shumë specifike dhe të rralla, neni 6 mund të zbatohet edhe ndaj kërkesave për përsëritje të procedurës, atëherë kur përsëritja e tyre mbetet mjeti i vetëm juridik dhe vendimtar për të adresuar cenimet e të drejtave civile dhe mbrojtjen e të drejtave dhe detyrimeve civile të kërkuesve (shih *Melis v. Greece*, no. 30604/07, §§ 18-20, 22 July 2010)."

Në fund të këtij precedenti, **Gjykata e Strasburgut** analizon nëse këto si më sipër mund të gjejnë zbatim në rastin konkret, për të përfunduar se parimet si më sipër këtu nuk gjejnë zbatim për faktin e thjeshtë se vendimi i ndërmjetëm (interlokutor) në këtë rast nuk ka pasur asnjë efekt dhe ndikim në të drejtat civile të parashtruesit të kërkesës. Qëllimi i vetëm i tij ka qenë për t'i hapur rrugë gjykimit dhe vendosjes lidhur me kërkesën meritore, e cila në kohën e marrjes së vendimit në **Strasburg** ka qenë duke u zhvilluar në vendin e origjinës, në **Austri**. Kjo do të thotë, për pasojë, se këtu nuk ka pasur vend për zbatimin të nenit 6.1 të Konventës ngaqë nuk është vendosur për të drejtat civile të parashtruesit të kërkesës: një gjë e tillë vendoset kur të gjykohet në procedurat e rinisura pas marrjes së vendimit interlokutor (të ndërmjetëm) të përshkruar si më sipër.[231].

16.13.5.Precedenti pestë: *Dichev kundër Bullgarisë,* nr. 1355/04, Aktgjykim i 27 janarit 2011

Parashtruesi i kërkesës në këtë rast ka ngritur disa kërkesa të natyrës procedurale dhe një kërkesë të natyrës materiale. Të llojit të parë janë kërkesat që bazohen në garancitë procedurale nga neni 6.1 të Konventës dhe kanë të bëjnë me: mohimin e të drejtës për qasje në gjykatë, zvarritjen e paarsyeshme të procedurave dhe cenimin e barazisë së armëve. E llojit të dytë, ndërkaq, është kërkesa materiale që bazohet në nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës (e drejta e pronësisë).[232] Neve këtu na intereson vetëm pjesa e vendimit që ka të bëjë me kërkesën e palës për përsëritje të procedurës dhe pohimet e tij lidhur me cenimin e barazisë së armëve, për shkak se kjo pjesë është përdorur në mënyrë arbitrare nga Gjykata Kushtetuese për të arsyetuar vendimmarrjen e vet në **rastin e dytë:** ***rastet KI 80/15, KI 81/15 dhe KI 82/15 (të bashkuara)***.

Gjykata e Strasburgut në vendimin për refuzim të kërkesës për përsëritje të procedurës ka theksuar se një kërkesë e tillë nuk mbështetet në garancitë procedurale të nenit 6.1 të Konventës, pa dhënë arsye të tjera pos citimit të praktikës së saj të mëhershme, të cilën ne e kemi përpunuar më sipër. Nga ato që kemi parë më sipër, sipas Strasburgut, neni 6.1 i Konventës nuk gjen zbatim, në parim, në rastet e kërkesave për përsëritje të procedurës. Kjo është kështu sepse, në këto lloje të kërkesave nuk vendoset për të drejtat civile në kuptim të nenit 6.1 të Konventës ashtu që edhe zbatimi i garancive procedurale nuk ka kuptim. Aty ku gjen zbatim neni 6.1 i Konventës, gjithnjë sipas praktikës gjyqësore në Strasburg që citohet nga vetë **Gjykata Kushtetuese** në rastin e saj të dytë si më sipër (***rastet KI 80/15, KI 81/15 dhe KI 82/15 (të bashkuara***), bëhet fjalë për rastet në të cilat preken të drejtat civile të palëve në procedurë.

Këto janë standardet minimale të ndërtuara në **Strasburg** lidhur me garancitë procedurale nga neni 6 i Konventës. Kur mbikëqyr realizimin e këtyre standardeve nga ana e shteteve anëtare, **Gjykata e Strasburgut** vepron si gjykatë kushtetuese.[233] Këto standarde duhet t'i vë në jetë **Gjykata Kushtetuese** në pajtim me nenin 53 të Kushtetutës, jo të substituohet (zëvendësohet) në vend të **Gjykatës së Strasburgut**, sepse nuk është gjykatë ndërkombëtare por gjykatë nacionale. Nëse **Gjykata Kushtetuese** i shikon gjërat nga këndvështrimi i një gjykate ndërkombëtare duke u mbështetur në premisën se garancitë procedurale nga neni 6.1 i Konventës nuk zbatohen në rastet e kërkesave për përsëritje të procedurës, atëherë ajo i krijon vetes një diskrecion për vendosje arbitrare: parashtresat në Gjykatë kanë për objekt

---

231 Ibid., paragrafët 25-27 dhe pjesa operative e vendimit.

232 **COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS. CASE OF DICHEV v. BULGARIA** *(Application no. 1355/04)* JUDGMENT. STRASBOURG 27 January 2011. **FINAL.** *20/06/2011*. Paragrafët: 3, 21, 32 & 35.

233 Robert Harmsen, "The European Court of Human Ruights as a 'Constitutional Court': Definitional Debates and the Dynamics of Reform". Në John Morison, Kieran McEvoy, and Gordon Anthony (eds.), *Judges, Transition, and Human Rights* (Oxford University Press: 2007) fq. 33-54; Janneke Gerards, "The European Court of Human Rights". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 237-276 në fq. 239-241.

një kërkesë për kontroll kushtetues të një vendimi të organit publik. Kërkesat për përsëritje të procedurës, ndërkaq, u takojnë procedurave autonome që zhvillohen dhe vendosen në gjykatat e rregullta: atje mund të ndodhin padrejtësitë kushtetuese për të cilat ankohet pala dhe që kanë një **petitum** tërësisht kushtetues që është larg gjendjes faktike në origjinë të krijimit të rastit. Gjykata Kushtetuese ka për detyrë për të konstatuar nëse vendimi i gjyqësorit të rregullt është i përlyer me shkelje kushtetuese në të gjitha fazat e kërkesave për përsëritje të procedurës dhe jo të konstatoj se nuk zbatohet neni 6 i Konventës në procedurat në fjalë sepse nuk ka statusin e një gjykate ndërkombëtare. Nëse në praktikën e Strasburgut neni 6.1 i Konventës nuk gjen zbatim në të gjitha kërkesat që tërthorazi kanë të bëjnë me përsëritje të procedurës, kjo nuk nënkupton se pala dhe shtetasit e shteteve anëtare të Konventës janë të privuar nga e drejta për të kërkuar përsëritjen e procedurës si një mjet juridik i njohur në të gjitha sistemet juridiko-kushtetuese të Evropës.

Nuk mund të kontestohet fakti se përsëritja e procedurës përbën një mjet dhe institut të rëndësishëm juridik nacional në çdo vend evropian, që ka natyrë tërësisht autonome. Ky nuk është rasti me **Gjykatën e Strasburgut**, ku përsëritja e procedurës mund të urdhërohet vetëm përjashtimisht si mjet i vetëm për ofrimin e satisfaksionit të drejtë nga neni 41 i Konventës. Në nivel nacional, ndërkaq, përsëritja e procedurës nuk është garanci procedurale por institut dhe mjet i fuqishëm juridik për realizmin e lirive dhe të drejtave të qytetarëve të përcaktuara qartë me kushtetutë dhe ligjet nacionale. Nuk ka procedurë gjyqësore (civile, penale dhe administrative) në sistemin kontinental dhe sistemin e të drejtës së përgjithshme (**common law**) që nuk njeh institutin që normon mjetin juridik të përsëritjes së procedurës, duke përcaktuar në mënyrë të qartë kushtet dhe rrethanat për përdorimin e tij. Në këtë kuptim, instituti në fjalë është një e drejtë e palëve në procedurë që mund të shfrytëzohet sipas kushteve dhe afateve kohore të përcaktuara qartë me ligje nacionale. Mohimi i kësaj të drejte përbën jo vetëm cenim kushtetues por edhe cenim të dispozitave të Konventës, pikërisht të atyre dispozitave të saj që kanë të bëjnë me nenin 13 që garanton të drejtën për mjet efektiv juridik.

E drejta e përsëritjes së procedurës, u mor vesh, nuk ekziston si një e drejtë autonome që figuron në tekstet kushtetuese të vendeve nacionale, për arsye të thjeshtë se nuk është në natyrën e dispozitave kushtetuese që të përmbajnë një të drejtë të tillë. Si e tillë, ajo përfshihet në kuadër të dispozitave të së drejtës pozitive kushtetuese në kuptim të nenit 6.1 të Konventës. Si institut, ndërkaq, përsëritja e procedurës rregullohet me norma juridike mbi procedurat relevante në nivel nacional (administrative, penale dhe civile), që janë të qarta, konkrete dhe mjaft të detajuara. Kur mohimi i këtij instituti me vendim kushtetues afekton të drejtat tjera konkrete kushtetuese të natyrës materiale, siç janë, ta zëmë, e drejta e pronës, e drejta e privatësisë, e drejta e qasjes në dokumente publike, e drejta për të qenë i barabartë në një procedurë penale etj., një vendim i tillë mohues domosdo që prek (afekton) të drejtat civile dhe garancitë e tjera të natyrës juridiko-civile dhe juridiko-penale nga neni 6.1 i Konventës. Nga kjo del se kontrolli i kushtetutshmërisë sipas nenit 113.7 të Kushtetutës nuk lejon asnjë hapësirë që **Gjykata Kushtetuese** të luajë rolin e një gjykate ndërkombëtare, sepse në mes saj dhe organeve të tjera nuk ekziston një marrëdhënie sovraniteti por marrëdhënie të qarta kushtetuese ku secili prej tyre ka juridiksion të qartë kushtetues. Në kuadër të këtij juridiksioni bën pjesë edhe ai nga neni 113.7 i Kushtetutës që i jep **Gjykatës Kushtetuese** të drejtën ekskluzive për vlerësim kushtetues të vendimeve për refuzim të kërkesës për përsëritjen e procedurës pranë gjykatave të rregullta. Me këtë rast Gjykata si parametër mund t'i përdorë garancitë procedurale nga neni 31 i Kushtetutës lidhur me nenit 6.1 i Konventës për shkak të thjeshtë se përsëritja e procedurës ka një natyrë autonome, të përcaktuar me ligje sistemike procedurale nacionale në një mënyrë të qartë dhe te detajuar. E thënë me fjalë të tjera, për faktin se mohimi i kërkesës për **përsëritje të procedurës** bëhet në një procedurë të veçantë dhe autonome, që quhet **kërkesë për përsëritje të procedurës**, bën që aty të zbatohen të gjitha garancitë nga neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës, si dhe dispozitat tjera mbi liritë dhe të drejtat kushtetuese nga kapitulli i dytë dhe i tretë i Kushtetutës. Jo vetëm kaq! Siç e pamë më sipër, në jurisprudencën e **Gjykatës së Strasburgut** zbatohen garancitë procedurale edhe ndaj kërkesave që kanë natyrë të përkohshme, përkatësisht **interlokutore** dhe **jomeritore**, për shkak se ato prekin liritë dhe të drejtat e shtetasve të shteteve anëtare të Konventës.

Asnjëri prej dy funksioneve të **Gjykatës së Strasburgut**, funksioni mbikëqyrës i zbatimit të Konventës nga ana e shteteve anëtare dhe funksioni kushtetues si vënës i standardeve minimale lidhur me liritë dhe të drejtat e garantuara me Konventë, nuk mund të ushtrohen nga asnjë gjykatë kushtetuese nacionale. Në rast se një gjykatë kushtetuese e një vendi anëtar në Konventë do të vendoste pozitivisht lidhur me ankesën kushtetuese që ka për objekt të tërthortë rrëzimin e kërkesës për përsëritje të procedurës nga gjykatat dhe organet tjera, për çfarëdo arsyeje, atëherë ajo nuk do të urdhëronte përsëritjen e procedurës por vetëm konstatimin e cenimit të standardeve minimale mbi garancitë procedurale nga neni 6.1 i Konventës. Këto cenime kanë ndodhur në një procedurë autonome që quhet **përsëritje e procedurës** dhe që ka kornizë të qartë brenda së cilës mund dhe duhet të zhvillohet. Çdo mohim i kësaj të drejte, pra të drejtës për të kërkuar përsëritje të procedurës sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara ligjore, përbën cenim të së drejtës për qasje në gjyq. E drejta për qasje në gjyq hyn në kuadër të garancioneve procedurale nga neni 6.1 i Konventës, gjë që e ka konstatuar vetë **Gjykata e Strasburgut** në rastin kundër **Bullgarisë** që diskutojmë këtu.[234] E kemi fjalën për mohimin që ndodh në procedurat pranë gjykatave të rregullta dhe organeve të tjera të juridiksionit të përgjithshëm. Kur kjo ndodh pranë Gjykatës Kushtetuese, atëherë kemi të bëjmë me cenimin e të drejtës për mjete juridike nga neni 32 i Kushtetutës.

Në procedurat sipas nenit 113.7 të Kushtetutës vjen deri te anulimi i vendimit përfundimtar të gjykatës së rregullt apo i organit tjetër për shkak të cenimit të së drejtës materiale origjinale, ta zëmë të drejtës për pronë, siç ka qenë rasti me **Bullgarinë** që diskutojmë në këtë seksion, por për shkak të cenimit të garancive procedurale nga neni 6.1 i Konventës që mund të kenë ndodhur në kuadër të refuzimit pa të drejtë dhe në mënyrë arbitrare të kërkesës për përsëritje të procedurës nga ana e autoriteteve vendore. E njëjta vlen edhe për raportin e gjykatave kushtetuese nacionale kundrejt vendimeve të gjyqësorit të rregullt apo vendimit të organit tjetër vendimmarrës: në asnjë rast gjykatat nacionale nuk konstatojnë cenimin e të drejtave origjinale kushtetuese, ta zëmë të drejtës për pronë, por të garancive kushtetuese procedurale lidhur me mënyrën e shqyrtimit dhe vendosjes për kërkesën lidhur me përsëritjen e procedurës.

16.13.6.Precedenti gjashtë: *Oberschlick kundër Austrisë,* nr. 23727/94, Aktvendim për papranueshmëri i 21 marsit 1994

Ky vendim dhe disa të tjerë citohen në paragrafët 64-65 të Aktvendimit për Papranueshmëri në rastin **KI 07/17** (diskutuar më sipër si rasti tretë), mirëpo pa cituar asnjë paragraf të vetëm se si këto raste të **Strasburgut** pajtohen me rastin që ka vendosur **Gjykata Kushtetuese** (sic!). **Gjykata e Strasburgut**, ndërkaq, në secilin rast që e merr si precedent shtjellon se si ana e tij faktike dhe juridike përshtatet me rastin që ajo vetë e shqyrton dhe vendos. Të shohim në vijim si duket ky precedent dhe konteksti në të cilin është cituar nga **Gjykata Kushtetuese**.

Në vitin 1991, **Gjykata e Strasburgut** kishte gjetur cenim të nenit 10 të Konventës si pasojë e dënimit të parashtruesit për shpifje nga gjykatat austriake. Veç kësaj shkeljeje, **Strasburgu** kishte gjetur shkelje edhe të nenit 6.1 të Konventës për shkak se në apelim kishin marrë pjesë gjyqtarët e njëjtë që kishin qenë vendimmarrës në procedurat e tjera të të njëjtit rast. Bazuar në vendimin e vitit 1991 si më sipër, parashtruesi kishte kërkuar nga gjykatat vendore rihapjen e procedurave në të cilat ishte dënuar për shpifje, duke e cilësuar vendimin me të cilin kishte fituar rastin në **Strasburg** si një fakt i ri. **Gjykata Supreme e Austrisë** kishte refuzuar këtë kërkesë, në ndërkohë që e kishte pranuar kërkesën për anulim të vendimit në të cilin kishte pasur konflikt interesi te gjyqtarët që kishin marrë pjesë në dy instanca gjyqësore kundër parashtruesit të kërkesës. Arsyeja për refuzim të kërkesës për përsëritje të procedurës nga ana e gjykatave

[234] **COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS. CASE OF DICHEV v. BULGARIA,** paragrafët 33 – 34 (këtu, megjithatë, **Gjykata Strasburgut** kërkesën e ka shpallur si qartazi të pabazuar).

austriake konsistonte në atë se vendimi i **Strasburgut** nuk përbënte fakt të ri. Ai vendim, sipas **Gjykatës së Strasburgut**, nuk ishte asgjë tjetër pos një vlerësim dhe cilësim i ndryshëm i fakteve të njëjta për aq sa ato kanë të bëjnë me veprën e shpifjes.[235]

Pas këtij refuzimi në nivel nacional, parashtruesi sërish iu është drejtuar **Strasburgut** me kërkesë për ekzekutim të vendimit me të cilin ishte konstatuar shkelja e nenit 10 të Konventës. **Gjykata e Strasburgut** ka refuzuar këtë kërkesë për ekzekutim të parashtruesit me arsyetimin se një gjë e tillë nuk bie **ratione materiae** në kuadër të juridiksionit të saj. Një gjë e tillë ishte juridiksion i **Komitetit të Ministrave**, i cili detyrimin për mbikëqyrje të ekzekutimit të vendimit të **Gjykatës së Strasburgut** e kishte kryer me rezolutën e vet të datës 14 dhjetor 1993.[236]

Njëjtë si me shumicën e gjykatave kushtetuese, përfshirë Kosovën, vendimet e **Strasburgut** kanë karakter deklarativ, siç e theksuam më herët, dhe kanë natyrë të vetekzekutueshme. Organi që e mbikëqyr zbatimin e vendimeve, **Komiteti i Ministrave**, vetëm mund të konstatojë nëse ka ardhur deri te zbatimi i këtij zotimi për ekzekutim të vendimeve, zotim që shtetet anëtare e marrin me rastin e hyrjes në Konventë.

Në këtë kohë, **Austria** ende nuk ka pasur në legjislacionin e saj dispozita që detyrojnë rihapjen e procedurës për adresim të cenimit të Konventës si pasojë e vendimit jo të favorshëm për shtetin. Më pastaj, **Austria**, së bashku me **Gjermaninë** dhe **Italinë**, futet në mesin e shteteve që lejojnë rihapjen e procedurave sipas vendimit të **Gjykatës së Strasburgut** me të cilin konstatohet shkelja e Konventës. Në këtë grup hyjnë edhe disa vende ish-komuniste. Në këto vende, vendimi i **Strasburgut** shërben si fakt apo provë e re. Sikundër dihet, një fakt apo provë e re, në të gjitha vendet evropiane paraqitet ligjërisht njëri ndër kushtet thelbësore për përsëritje të një procedure gjyqësore të mbyllur me vendim të formës së prerë.

Austria këtë ndryshim në legjislacionin penal për qëllim të akomodimit të detyrimeve të saj ndaj vendimeve të **Gjykatës së Strasburgut** e ka bërë në vitin 1996 dhe atë vetëm pas dy vendimeve të dhëna kundër saj. Ky standard vlen vetëm sa i përket procedurave penale të mbyllura me vendim të formës së prerë, por jo edhe për procedurat civile dhe administrative: në këto raste, palët nuk kanë të drejtë të përdorin vendimin e **Gjykatës së Strasburgut** si një fakt të ri për rihapjen e procedurave të mbyllura me vendim të formës së prerë. Për këto raste vlen rregulli i mësipërm: **Komiteti i Ministrave** mbikëqyr vetëm zbatimin e vendimeve të **Strasburgut** dhe me një rezolutë konstaton nëse ka ndodhur ekzekutimi. Me kaq çdo gjë mbyllet.[237]

Nuk është kontestuese që në rastet e kërkesave për përsëritje të procedurës nuk bëhet fjalë për procedurë origjinale, sepse ajo është mbyllur me vendim të formës së prerë. Kjo bën që neni 6.1 i Konventës të mos gjejë zbatim sa i përket ankesave pranë **Gjykatës së Strasburgut** që pohojnë se niveli nacional ka ardhur deri te refuzimi i kërkesës për përsëritje të procedurës. Kjo është kështu, sepse neni 6 i Konventës përmban garanci procedurale për çdo procedurë që ka të bëjë me caktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile apo me çështje penale në nivel nacional. Kjo nënkupton që nëse në nivel nacional ekzistojnë detyrime të marra ndërkombëtare, siç janë ato që parashikojnë se rihapja e procedurave ndodh çdoherë kur ka një detyrim ndërkombëtar për t'u vënë në jetë, atëherë vendimi ndërkombëtar, në këtë rast vendimi i **Strasburgut**, shërben si një fakt i ri dhe jo vlerësim tjetër i të njëjtës situatë juridike. Në kohën e marrjes së vendimit

---

235 **COMMISSION EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME / EUROPEAN COMMISION OF HUMAN RIGHTS.** *DÉCISION SUR LA* RECEVABILITÉ. Application No. 23727/94 by *Gerhard OBERSCHLICK against Austria.* **The Facts. Në internet:** https://www.menschenrechte.ac.at/orig/ 954/ Oberschlickcv% 20AZE.pdf shikuar në dhjetor 2020).

236 Ibid., pargarafi 1.

237 Cf. më shumë për këtë në: Hannes Treter, "The implementation of judgements of the European Court of Human Rights in Austria". Në Thomas Barkhuysen, Michiel Leonard van Emmerik and Piet Hein van Kempen (eds,), *The Execution of Strasbourg and Geneva Human Rights Decisions in the National Legal Prder* (Martinus Nijhoff Publishers: The Hague/Boston /London, 1999) fq. 167-182 në fq.176-181.

si më sipër, **Austria** nuk ka pasur detyrim ndërkombëtar për një gjë të tillë sepse nuk ka pasur legjislacion që implementim detyrimin e tillë. Këtë e thamë më sipër.

Përveç këtij rasti, përsëritja e procedurës mund të shërbejë si mjet apo si mënyra e realizmit të satisfaksionit të drejtë, në fakt si mënyra e vetme për të adresuar ankesat e palës fituese të një rasti. Në këto raste, **Gjykata e Strasburgut** me vendimin e saj mund të përcaktojë se rihapja e procedurave përbën mënyrën dhe mjetin e duhur dhe të drejtën për rivënien e drejtësisë dhe restaurimin e të drejtave nga Konventa të cilat janë cenuar në një proces të mëhershëm juridik në nivel nacional. Këto i thamë në seksionit paraprak kur shënuam se vetë Strasburgu në paktin e vet gjyqësor ka theksuar se edhe në vendimet **interlokutore** (të ndërmjetme) mund të vijë në shprehje zbatimi i nenit 6 të Konventës, përfshirë këtu kërkesat për përsëritje kur ato janë të vetmet mënyra dhe mjete për vënien në jetë të zotimeve të shteteve anëtare që ato i kanë marrë me rastin e bërjes palë në Konventë.

Dy situatat si më sipër, megjithatë, nuk vlejnë kur dështimi i palës për të fituar drejtësi sipas kërkesës për përsëritje të procedurës ka ndodhur në nivel të procedurave nacionale. Kjo është kështu sepse Konventa len hapësirë të madhe veprimi për shtetet anëtare të **KE-së**: krejt që shtetet anëtare duhet të bëjnë është të ofrojnë procedura dhe mekanizma që më së miri mbrojnë të drejtat dhe liritë nga Konventa, përfshirë ato që kanë të bëjnë me përsëritjen e procedurave të mbyllura me vendim të formës së prerë. Në kuptim të vënies në jetë të këtij zotimi duhen parë zgjidhjet juridike të të gjitha vendeve evropiane të cilat, pa asnjë përjashtim, përcaktojnë mekanizma të detajuar dhe të qartë me qëllim të vënies në jetë të institutit juridik në të cilin mishërohet mjeti juridik i njohur si **përsëritja e procedurës**. Në kuadër të këtyre normave juridike hyjnë edhe normat kushtetuese, mbi të gjitha normat kushtetuese, ato ligjore dhe normat e natyrës tjetër, kushtetutshmëria e të cilave prezumohet. Mbi gjykatat nacionale kushtetuese bie detyrimi për të siguruar supremacinë (epërsinë) e kushtetutës nacionale dhe të krejt infrastrukturës tjetër juridike që bazohet në kushtetutë nacionale. Në sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut, kur bëhet fjalë për **Kosovën**, detyrimi për sigurimin e supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës nga ana e **Gjykatës Kushtetuese** reflektohet në detyrimin kushtetues nga neni 53 i Kushtetutës. Interpretimi i çdo rasti dhe mosmarrëveshjeje kushtetuese duhet të kryhet konform standardeve të vëna nga Gjykata e Strasburgut. Kjo nuk do të thotë, megjithatë, detyrim për t'u zëvendësuar (substituar) në vend të Gjykatës së Strasburgut, e cila është një mekanizëm ndërkombëtar i karakterit evropian.

Instituti përsëritjes së procedurës në **Kosovë**, si një mjet juridik, gëzon mbrojtje kushtetuese siç gëzojnë të gjitha mjetet juridike. Ajo hyn në kategorinë e mjeteve juridike në kuptim të nenit 32 të Kushtetutës. Mohimi i këtij mjeti, përveç që përbën mohim të qasjes në gjykatë nga neni 6.1 i Kushtetutës, si njëri ndër përbërësit e këtij neni, siç e ka konstatuar vetë **Gjykata e Strasburgut** (në vendimin që diskutuam me herët), përbën cenim të nenit 32 të Kushtetutës. Nuk do mend, nga kjo që u tha, se është detyrë e **Gjykatës Kushtetues** që të vlerësojë, me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) sipas nenit 16 të Kushtetutës, nëse e drejta për mjet juridik që quhet përsëritje e procedurës ka qenë e mohuar në mënyra jo kushtetuese, përkatësisht të vlerësojë nëse vendimi i marrë në këtë procedurë në çfarëdo mënyre është i përlyer me cenime të Kushtetutës.

16.13.7. Precedenti shtatë: *Dowsett kundër Mbretërisë së Bashkuar,* nr. 8559/08, Aktvendim për papranueshmëri i 4 janarit 2011

Ky rast ka pasur të bëjë me një dënim penal të përjetshëm të parashtruesit të kërkesës. Aplikacioni i tij në **Strasburg** ka pasur për **petitum** ekzekutimin e një vendimi të mëhershëm të **Gjykatës së Strasburgut** *të vitit 2003, me të cilin vendim ishin gjetur shkelje të nenit 6.1 të Konventës (cenimi i barazisë së armëve për shkak të fshehjes së provave të favorshme për parashtruesin). Bazuar në këtë vendim, pala fituese kishte kërkuar ekzekutimin e tij, sërish në* **Strasburg**, për shkak se autoritetet britanike nuk kishin ndërmarrë asnjë masë për të vënë në jetë këtë shkelje të konstatuar me këtë vendim.

Për dallim nga rastet e si më sipër, parashtruesi në aplikacionin e dytë për ekzekutim të vendimit të parë kishte theksuar se ishte i vetëdijshëm që neni 6.1 i Konventës nuk gjente zbatim në kërkesat për rihapje

të procedurave të mbyllura me vendim të formës së prerë, nisur nga fakti se një gjë e tillë as nuk ishte kërkuar me vendimin origjinal (vendimi i parë i Strasburgut të vitit 2003). Këtë herë, parashtruesi theksonte se kishte ngel viktimë në kuptim të nenit 34 të Konventës dhe se gjendja e tij përbente cenim të vazhdueshëm të saj. Në të njëjtën koha, sa i përket nenit 6 të Konventës, parashtruesi theksonte se kjo gjendje e vazhdueshme cenonte edhe këtë nen për shkak se ishte i privuar nga mbrojtja efektive. Sipas tij, në këto rrethana, kjo gjendje ku shteti i tij nuk kishte ndërmarr masat e duhura për evitim të cenimit të vazhdueshëm të Konventës përbente fakt dhe rrethanë të re për çka duhej të vendoste **Strasburgu** sipas **parimit të subsidiaritetit.**[238]

Në vendimin e **Gjykatës së Strasburgut** lidhur me këtë rast, i dhënë mbi bazën e praktikës së saj të mëhershme lidhur me përsëritjen e procedurës, u trajtua dallimi në mes të dy situatave. Këto situata janë si vijon: e para, kur përsëritja e procedurës është kërkuar me vendimin e parë të **Gjykatës së Strasburgut** me të cilin është konstatuar cenimi i Konventës; dhe, e dyta, kur përsëritja e procedurës fare nuk është trajtuar në vendimin e parë të **Gjykatës së Strasburgut**, e cila, në të njëjtën kohë, me po atë vendim ka autorizuar shtetin përgjegjës që vetë të vlerësojë se cilat masa janë të duhura për t'u ndërmarrë në emër të ofrimit të satisfaksionit të drejtë në kuptim ët nenit 41 të Konventës.

Gjykata e Strasburgut me këtë rast e ka bërë të qartë se nuk ka të drejtë të urdhërojë rihapjen e gjykimit apo anulimin e dënimit të shqiptuar. Përjashtim nga kjo rregull bëjnë rastet kur me vendim të saj konstatohet cenimi i Konventës dhe parashikohet edhe përsëritja e procedurës si një ndër mënyrat për adresimin e cenimit të tillë të konstatuar (satisfaksioni i drejtë në kuptim të nenit 41 të Konventës, atëherë kur masat nacionale nuk mjaftojnë për të adresuar shkeljen e gjetur të Konventës). Këto janë vendimet e **Strasburgut** *të llojit të parë si më sipër. Në rastin e vendimeve të llojit të dytë, ndërkaq,* **Gjykata e Strasburgut** ka theksuar se shtetet palë në Konventë me të cilat ka të bëjë vendimi kanë të drejtë që vetë t'i zgjedhin mjetet adekuate për të adresuar shkeljen e konstatuar me vendim të saj. Rasti i parashtruesit të kërkesës së dytë, e vendosur me këtë vendim, ka pasur të bëjë pikërisht me situatën e dytë dhe, për pasojë, **Strasburgu** e shpalli kërkesën si të papranueshme.[239] Shënojmë këtu se, në të gjitha rastet e trajtuara këtu me këtë vendim, përfshirë praktikën e përdorur për këtë rast nga **Gjykata e Strasburgut**, bëhet fjalë, njëjtë si në rastin e sipërm, me kërkesa për realizimin e përsëritjeve të procedurave penale të mbyllura në nivel nacional, të cilat kanë pasur si baza një vendim të **Strasburgut** *që ka gjetur shkelje të Konventës, pra jo me kërkesa për përsëritje të procedurave që kanë nisur dhe janë mbyllur ekskluzivisht në nivel nacional.*

Në pjesën e vendimit që ka të bëjë me faktet e krijimit të rastit, **Gjykata e Strasburgut** ka dhënë pjesë të caktuara nga **Rekomandimi i Komitetit të Ministrave i datës 19 janar 2000, Rekomandimi 2000 (2)**, i cili i referohet ekzekutimit të vendimeve të marra në **Strasburg**. Këtë e ka bërë për të provuar sërish se nuk është detyrim i saj mbikëqyrja e ekzekutimit të vendimeve të **Gjykatës së Strasburgut**, por një detyrim që i takon **Komitetit të Ministrave**. Ky detyrim i mbikëqyrjes nuk largon detyrimin e shteteve anëtare sipas nenit 46 të Konventës, detyrim sipas të cilit shtete anëtare janë zotuar për të ekzekutuar vendimet e **Gjykatës së Strasburgut** *në mënyrë vullnetare. U mor vesh, këtu bëhet fjalë për ekzekutimin e vendimeve në të cilat që janë palë vetë shtetet anëtare, pra jo për vendimet dhe standardet e* **Gjykatës së Strasburgut** të ndërtuara në rastet tjera ku ato vetë nuk kanë qenë palë. Ky zotim, gjithnjë sipas rekomandimit të sipër cekur **Komitetit të Ministrave**, të cilin **Gjykata e Strasburgut** e citon me miratim, nënkupton marrjen e masave të tjera pos atyre që ka urdhëruar Strasburgu në vendimin e vet sipas nenit 41 të Konventës mbi satisfaksionin e drejtë.

Ato masa në nivel nacional, të cilat shtetet anëtare rekomandohet që t'i ndërmarrin me qëllim të adresimit të shkeljeve të Konventës të konstatuara me vendim të **Gjykatës së Strasburgut**, kanë të bëjnë me rikrijimin e gjendjes së mëparshme (**restitucio in integrum**) që ka ekzistuar para cenimit të Konventës,

---

238 **COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME / EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS. FOURTH SECTION DECISION AS TO THE ADMISSIBILITY OF**. *Application no. 8559/08 by James DOWSETT (No. 2) against the United Kingdom*. "**The Law".**

239 Ibid., po aty.

për aq sa një gjë e tillë të jetë e mundur. Në këto masa nacionale, që kanë për qëllim krijimin e gjendjes së mëparshme (**restitucio in integrum**) mund të llogariten edhe përsëritjet e procedurave të mbyllura me vendime të formës së prerë, gjithnjë sipas Rekomandimit të datës 19 janar 2000 si më sipër, i cituar me miratim nga **Gjykata e Strasburgut**. Në fakt, në këtë kuptim, përsëritja e procedurës shfaqet si i vetmi mjet për adresimin e cenimit të Konventës. Këto observime të **Gjykatës të Strasburgut**, përsërisim sërish, të cilat mbështeten në tërësi në **Rekomandimin nr. 2000 (2) të Komitetit të Ministrave të datës 19 janar 2000**, të cekur si më sipër, kanë të bëjnë ekskluzivisht me ekzekutimin në nivel nacional të vendimeve të **Gjykatës së Strasburgut** *përmes përsëritjes së procedurave të mbyllura me vendim të formës së prerë nga ana e autoriteteve gjyqësore të shteteve palë në Konventë. Këtu qartë është thënë se në disa situata, përsëritja e procedurave mund të paraqitet si mjeti i vetëm për sanimin e shkeljes së konstatuar të Konventës.*[240]

Këto masa janë të domosdoshme, gjithnjë sipas vlerësimit të Strasburgut në këtë rast, sepse në disa situata, parashtruesi që ka fituar mund të përjetojë viktimizim të përhershëm si pasojë e moszbatimit të vendimit të **Gjykatës së Strasburgut**. Veç kësaj, ky viktimizim ndodh edhe atëherë kur shihet se vendimi i Strasburgut shpie në përfundimin që:

- vendimi i kontestuar nacional ka të meta dhe gabime serioze materiale në meritat e rastit; dhe
- cenimi i Konventës ankorohet në gabimet ose të metat procedurale të natyrës së rëndë, aq sa, si të tilla, hedhin dyshime të mëdha në rezultatin e dëmshëm që kanë prodhuar për parashtruesin e kërkesës.

Gjykata e Strasburgut, pikërisht në rastet si më lart, inkurajon shtetet anëtare që të ndërmarrin të gjitha masat për ndryshim në sistemin e brendshëm juridik-kushtetues me qëllim të adresimit të cenimeve të Konventës. Këtu bëhet fjalë për rastet kur vetë shtetet janë palë në një gjykim të tillë në të cilin është konstatuar cenimi i Konventës, kurse satisfaksioni i drejtë i dhënë me vendim të **Gjykatës së Strasburgut** nuk mjafton për rikthim në gjendjen e mëparshme (**restitucio in integrum**). Me fjalë të tjera, **Strasburgu** me këtë vendim që po e diskutojmë, në mënyrë eksplicite ka inkurajuar shtetet që edhe përsëritjen e procedurës ta fusin në sistemin e tyre nacional si mënyrë dhe mjet për adresimin e shkeljeve të Konventës, nëse një gjë e tillë shihet si rruga e vetme për të akomoduar cenimet e Konventës dhe eliminimin e viktimizimit të parashtruesit të kërkesës në të ardhmen.[241]

16.13.8.Precedenti i tetë: *Franz Fischer kundër Austrisë* nr. 27569/02, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 majit 2003)

Këtu **Gjykata e Strasburgut** në një mënyrë të shkëlqyer ka vënë në spikam*ë* dy aspekte të nenit 6 të Konventës: e para, se procedurat juridike austriake që vihen në lëvizje sipas kërkesës për rigjykim duke u mbështetur në vendimet e **Strasburgut** që gjejnë shkelje të Konventës janë të ngjashme me institutin juridik të përsëritjes së procedurës në çështjet penale; dhe e dyta, se në këto procedura nuk vendoset për një akuzë penale në kuptim të fjalisë së parë të nenit 6.1 të Konventës, sepse vendimi për dënimin veç ka marrë formën e prerë, por vendoset nëse ekzistojnë kushtet për lejimin e rigjykimit të çështjes së gjykuar njëherë.[242]

Pas konstatimit si më sipër, **Gjykata e Strasburgut** konstaton se kërkesa është e palejueshme **ratione materiae**, mirëpo jo pse një gjë e tillë nuk hyn në nenin 6.1 të Konventës, siç mendon gabimisht **Gjykata Kushtetuese** në paragrafin 65 të vendimit në rastin **KI 07/17**, por sepse këtu bëhet fjalë për

---

[240] Ibid., pjesa:"**The Facts". C.** ***Execution of the Court's judgments: Recommendation No. R (2000) 2.***

[241] Ibid., po aty.

[242] **COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME / EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS. FIRST SECTION DECISION AS TO THE ADMISSIBILITY OF**. *Application no. 27569/02 by Franz FISCHER against Austria,* seksioni "**The Law**".

ekzekutimin e vendimit të saj me të cilin është gjetur cenimi i nenit 7 të Protokollit 4 në Konventës. Për ekzekutim, thuhet më tej në vendim, nuk *është* kompetent ajo, por **Komiteti i Ministrave**. Këtë e ka theksuar në paragrafin e fundit para se të vendosë për papranueshmërinë e kërkesës në këtë rast.[243]

Sikundër shihet, këtu vlejnë **mutatis mutandis**, krejt ato që u than*ë* më sipër për rastin e shtatë.

16.14.9. Përsëritja e procedurës si institut dhe mjet juridik efektiv në botën bashkëkohore, në Kosovë *Quo Vadis*?

Në secilin prej vendimeve të diskutuara dhe analizuara këtu vërehet se **Gjykata Kushtetuese** përdor standardin sipas të cilit në përsëritjet e proceduarve nuk zbatohen neni 6 i Konventës lidhur me nenin 31 i Kushtetutës. Me k*ët*ë konstatim **Gjykata Kushtetues** ka marrë rolin e një gjykate ndërkombëtare, duke qenë se ky veprim paraqet kontroll efektiv kushtetues të pajtueshmërisë se nenit 31 të Kushtetutës me nenin 6 të Konventës. Ky nuk *është* juridiksion i **Gjykatës Kushtetuese**, as këtu e askund gjetiu në Evropë e më gjerë. Në të njëjtën kohë, **Gjykata Kushtetuese** në katër vendimet e sipër diskutuara e lënë të pazgjidhur, pa i dhënë përgjigje, kërkesës së palëve që pretendojnë cenime të lirive dhe të drejtave tyre kushtetuese me vendime përfundimtare të gjykatave dhe organeve të tjera publike në Kosovë.

Teknika përmes së cilës bëhet kjo shkelje e lirive dhe të drejtave kushtetuese *është* kjo: katër kërkesa për cenim të lirive dhe të drejtave kushtetuese, të parashtruara sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, kanë për objekt të t*ë*rthort*ë* refuzimin e kërkesave të tyre për përsëritje të procedurës nga ana e gjykatave të rregullta. **Gjykata Kushtetuese**, ndërkaq, lidhur me kërkesën e palëve për cenim të lirive dhe të drejtave të tyre me vendime përfundimtare të autoriteteve publike jep përgjigje uniforme që thotë se në kërkesat e palëve për përsëritje të procedurës nuk zbatohet neni 6 i Konventës dhe, për pasojë, këto kërkesa janë **ratione materiae** jashtë juridiksionit të saj. Kjo bëhet duke besuar se precedentët e Gjykatës së Strasburgut, të cilat i citon Gjykata, provojnë se neni 6 i Konventës nuk gjen zbatim në katër rastet që i ka cilësuar si kërkesa për përsëritje të procedurës. Ato nuk kanë qenë dhe nuk mund të jenë kërkesa për përsëritje të procedurës por kërkesa për vlerësim të kushtetutshmërisë së vendimeve të autoriteteve publike kosovare për cenim të nenit 31 dhe neneve të tjera të Kushtetutës.

Citimet e bëra nga **Gjykata Kushtetuese** të precedentëve të Strasburgut janë gabim dhe arbitrare për disa arsye. Në rend të parë, siç u pa nga si më sipër, ato precedentë n*ë* të shumtën e rasteve kanë të bëjnë me ekzekutimin e vendimeve të **Gjykatës së Strasburgut**, përkatësisht me kërkesën fillestare të palës për përsëritje të procedurës së mbyllur në shtetin e paditur duke u bazuar në një vendim të favorshëm për të. Pas dështimit të palëve fituese për të rihapur procedurat vendore duke u mbështetur në vendime të favorshme të **Gjykatës së Strasburgut**, ato janë drejtuar në **Strasburg** për ndihmë, kët*ë* herë për ekzekutim të vendimit të favorshëm. **Gjykata e Strasburgut** në të gjitha rastet e ka bërë të ditur se vendimet e saj kanë karakter deklarativ dhe janë të vetekzekutueshme, duke e lënë në diskrecion të shteteve anëtare të **Këshillit të Evropës** gjetjen e mënyrave të përshtatshme për përmbushje të zotimeve të marra për zbatim të vendimeve të saj. Për ekzekutim të tyre, ndërkaq, sipas standardit ligjor, kompetent *është* **Komiteti i Ministrave**, dhe jo **Gjykata e Strasburgut**. I vetmi përjashtim nga kjo janë rastet kur **Gjykata e Strasburgut**, me vendim të vet përcakton përsëritjen e procedurës si mënyra të vetme për të adresuar cenimin kushtetues, me synim rikthimin në gjendjen e mëparshme (**restitutio in integrum**).

Së dyti, edhe atëherë kur kërkesa për përsëritje të procedurës ka të bëjë me vendimet e organeve nacionale, precedentët e përdorur nga **Gjykata Kushtetuese** interpretohen në mënyrë të gabuar. Kjo *është* kështu për shkak se rastet kur vendet anëtare të Konventës lejojnë përsëritjen e procedurave si pasojë e cenimeve të saj të konstatuara nga **Gjykata e Strasburgut**, këtë e bëjnë mbi bazën e

[243] Ibid., po aty.

legjislacion implementues, të miratuar për vënien në jetë të zotimeve nga Konventa. Ky legjislacion lejon, siç u pa më sipër, ekzekutimin e vendimeve të **Gjykatës së Strasburgut** përmes hapjes së procedurave të mbyllura me vendim të formës së prerë. *Kë*tu vendimet që gjejnë shkelje të Konventës shërbejnë si fakt apo rrethanë e re, cilësi kjo që fitohet përmes legjislacionit implementues të vendimeve të **Gjykatës së Strasburgut** nga ana e shteteve anëtare të Konventës. Si shembuj përmenden rastet e **Austrisë**, **Gjermanisë** dhe **Italisë**, por edhe rastet e disa vendeve ish-komuniste. **Kosova** nuk hyn në asnjërin prej këtyre sepse nuk ka asnjë legjislacion implementues për vënien në jetë të vendimeve të tilla sepse nuk *është* anëtare e **KE** dhe, për pasojë, as anëtar i Konventës dhe **Gjykatës së Strasburgut**. Kjo nënkupton se vendimet e saj për Kosovën kanë karakter të dyfishtë deklarativ: së pari, ato ngërthejnë standarde që duhen ndjekur kundrejt lirive dhe të drejtave kushtetuese, për aq sa ato korrespondojnë me liritë dhe të drejtat e garantuara me Konventë; së dyti, ndër standardet e **Gjykatës së Strasburgut**, sikundër u pa, ishte edhe rihapja e procedurave të mbyllura me vendim të formës prerë në nivel nacional nëse ajo shihet si e vetmja mënyrë për të adresuar cenimin e Konventës me qëllim të rikthimit të gjendjes së mëparshme (**restitutio in integrum**).

Rastet kur vendet anëtare bëjnë rihapje të procedurave të mbyllura si pasojë e vendimeve të **Gjykatës së Strasburgut**, çdoherë kanë të bëjnë me vendet e saj anëtare. Kjo, për pasojë, do të thotë se këtu bëhet fjalë për vendime **inter partes**. Edhe në këtë aspekt Gjykata Kushtetuese nuk mund të përdor precedentët e Strasburgut në mënyrën siç i ka përdorur sepse nuk ka asnjë vendim ku Kosova është palë e ajo nuk mund të jetë palë sepse nuk është anëtare e **KE**-së. Ligjvënësi kosovar ka provuar në ligjet sistemike mbi procedurat civile[244] dhe procedurat penale[245] të fus dispozita të ngjashme me Austrinë, Gjermaninë, Italinë dhe vendet tjera evropiane. Këto zgjidhje, megjithatë, nuk kanë asnjë efekt praktik sepse Kosova nuk është palë në Konventë.

Këto dy aspekte si më sipër **Gjykata Kushtetuese** fare nuk i ka pasur parasysh. Nuk mund t'i ke*të* parasysh sepse askund në asnjë rast nuk ka bërë analizimin e anëve faktike dhe juridike të precedentëve të **Gjykatës së Strasburgut** me rastin e zbatimit të tyre si burime të së drejtës kushtetuese në katër rastet si më sipër. Më këtë ka bërë cenim të hapur të së drejtës për mjet juridik nga neni 32 i Kushtetutës. Ky cenim vjen si pasojë e faktit se Gjykata Kushtetuese ka l*ënë* pa përgjigje kërkesat e palëve nga neni 113.7 i Kushtetutës, në katër rastet si më sipër, duke shpallur veten si organ pa juridiksion **ratione materiae**.

---

244 Neni 141 [Vendimet Gjyqësore] i **Ligjit Nr. 03/L-006** për Procedurën Kontestimore (*Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.* Nr. 38, 20 shtator 2008, me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme):
"141.1 Kur Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstaton se është shkelur ndonjë e drejtë ose liri themelore e njeriut e paraparë në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut dhe në Protokollin plotësues të Konventës, pala brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita që ka marrë formë të prerë vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, mund të parashtrojë kërkesë për ndryshimin e vendimit me të cilin është shkelur ajo.
141.2 Kërkesa parashtrohet në Gjykatën e Kosovës që ka vepruar në shkallë të parë, në procedurën në të cilën është marrë vendimi, me të cilin është shkelur e drejta ose liria themelore e njeriut.
141.3 Në procedurën sipas kërkesës për ndryshimin e vendimit me të cilin është shkelur e drejta apo liria e njeriut, në mënyrë të përshtatshme zbatohen dispozitat e këtij ligji për përsëritjen e procedurës.
141.4 Në procedurën e përsëritur gjykata është e detyruar që t'i marrë në konsideratë qëndrimet e shprehura në vendimin e formës së prerë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut me të cilin është konstatuar shkelja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut."

245 Neni 433 ["Personat e autorizuar për të paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë] i **Kodit Nr. 04/L-123 të Procedurës Penale** (*Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*. Nr. 37, 28 dhjetor 2012):
" 1. Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqesë Kryeprokurori i Shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij. Pas vdekjes së të pandehurit, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të tij mund të paraqesin personat e paraparë në nenin 424, paragrafi 1. fjalia e fundit e këtij Kodi.
2. Kryeprokurori i shtetit, i pandehuri, mbrojtësi i tij dhe personat e paraparë në nenin 424, paragrafi 1. fjalia e fundit e këtij Kodi mund të paraqesin kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë brenda tre (3) muajve nga dita kur të pandehurit i është dorëzuar vendimi gjyqësor i formës së prerë. Nëse kundër vendimit të gjykatës themelore nuk paraqitet ankesë, afati rrjedh nga dita kur vendimi merr formë të prerë.
3. Kur me vendim të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut është vërtetuar se me vendim përfundimtar janë shkelur të drejtat e njeriut në dëm të të pandehurit, afati për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë rrjedh nga dita kur vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut i dorëzohet të pandehurit.
4. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 432, paragrafi 2. i këtij Kodi, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë nga paragrafi 3. i këtij neni mund të paraqitet edhe kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës."

Këto vendime të Gjykatës, në thelb, p*ë*rbëjnë **deni de justice** (mohim të drejtësisë për qytetarët) për shkak se vendimmarrja e saj në katër rastet e sipër cekura në mënyrë efektive nënkupton **non liquet** (paaftësi për ta zgjidhur apo vendosur rastin konkret). Ironia e fatit *është* se këtu Gjykata shpall veten **non liquet** duke u mbështetur në nenin 6 të Konventës dhe precedentët e **Strasburgut,** në ndërkoh*ë* që funksioni parësor i futjes së detyrimit nga neni 53 i Kushtetutës ka qenë dhe *ë*shtë të pamundësojë ekzistimin e zbraz*ët*irave juridike në lëmin e lirive të drejtave kushtetuese. Si e tillë, dispozita e këtij neni fuqizon **Gjykatën e Starsburgut** në sistemin kushtetues kosovar, duke ia mohuar asaj funksionin mbikëqyrës ndaj zbatimit të Konventës por, në të njëjtën kohë, duke ia njohur precedentëve të saj statusin e burimit të drejtpërdrejtë të së drejtës kushtetuese. Në Kosovë, **Gjykata e Strasburgut** nuk luan rolin e filtruesit të kërkesave nacionale për shkak se parimi i subsidaritetit nuk vlen ndaj juridiksioneve që nuk janë anëtarë të **KE-së**. Në vend të kësaj, ajo luan rolin e formësuesit të drejtpërdrejtë të vendimmarrjes sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, për shkak të detyrimit kushtetues nga neni 53 i Kushtetutës që detyron **Gjykatën Kushtetuese** për t'u furnizuar me material argumentativ me origjinë nga **Strasburgu** dhe që detyrimisht duhet të reflektohet në arsyetim të secilit vendim.

Nga hulumtimet bashkëkohore të institutit antik **non liquet** (pamundësi apo paaftësi për të vendosur rastin konkret), del se ai zakonisht lind si rezultat i humbjes së kuorumit në vazhdën e përjashtimit masiv të gjyqtarëve[246] dhe, pak më rrallë, në të drejtën nd*ë*rkomb*ë*tare publike, edhe si rezultat i ekzistimit të zbraztësirave juridike në sistem.[247] Historia e së drejtës na mëson, megjithatë, se asnjë vend modern nuk lejon që gjyqtaret ta shpallin veten **non liquet**. Shpallja e tillë përbën mohim të drejtësisë (**deni de justice**), gjë të cilën nuk mund ta bëjnë gjyqtaret sepse ata konsiderohen sipas kushtetutës dhe ligjit **functus officio**.[248] Dikur, në kohet e vjetra, shpallja **non liquet** iu lejohej vetëm magjistarëve romak. Në literaturë *është* vërejtur se e drejta romake, në fakt, ngelet sistemi i vetëm juridik që iu ka lejuar magjistarëve të drejtën për të shpallur veten **non liquet** apo të paaftë në një rast apo mosmarrëveshje të parashtruar për vendosje dhe zgjidhje, por vetëm sa i përket dyshimeve apo paqartësive të natyrës juridike.[249] Më vonë, në shekullin e 19-të, një veprim i tillë i gjyqtarëve ka qenë vepër penale në disa vende evropiane (Franca, Gjermania, Austria).[250]

Mbase rasti i jurisprudencës së nisur të **Gjykatës Kushtetuese** do të shënohet si rasti i dytë, pas sistemit juridik romak, në të cilin një organ kushtetues shpall veten **non liquet**, duke mohuar të drejtën kushtetuese të palëve për të marrë një përgjigje lidhur me kushtetutshmërinë e akteve juridike të autoriteteve publike lidhur me pohimet për cenimin e të drejtave të tyre kushtetuese. Kjo e drejtë ankorohet në nenin 113.7 të Kushtetutës. Kjo qasje e Gjykatës asnjëherë nuk mund të gjejë mbështetje në precedentët e **Gjykatës e Strasburgut**, të cilat, siç u pa, nuk kanë asnjë konkordanc*ë* me arsyetimet e dhëna të **Gjykatës Kushtetuese** në katër rastet e shpallura **ratione materiae** jashtë juridiksionit të saj.

Këto defekte serioze të gjetura në katër vendimet, të cilat vetidentifikohen nga Gjykata Kushtetuese si rastet e përsëritjes së procedurës, nuk janë veçse një pjesë e vendimmarrjes së saj ku qytetari ndeshet me cenim përfundimtar të pakthyeshëm të lirive dhe të drejtave kushtetuese, aty ku nuk e pret dhe në vendin

---

246 European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Opinion on Amendments to the Act of 25 June 2015 on the Constitutional Tribunal of Poland.* Adopted by the Venice Commission at its 106th Plenary Session (Venice, 11-12 March 2016). Opinion No. 833/2015. **Venice**, 11 March 2016. CDL – AD (2016 (001). Or. Engl.Paragrafi 37; European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Compilation of Venice Commission Opinions, Reports and Studies on Constitutional Justice (Updated)*, paragrafi 7.1.

247 William Michael Reisman, "International Non-Liquet: Recrudescence and Transformation". *International Lawyer* Vol. 3 No. 4 (July, 1969) fq. 770-786, në fq. 771-774; Craig Eggett, "The Role of Principles and General Principles in the 'Constitutional Processes' of International Law" *Netherlands International Law Review* Vol. 66 Issue (2019) fq. 197–217, në fq. 205-207 & 212.

248 Alfredo Mordechai Rabello, "Non Liquet: From Modern Law to Roman Law". *Annual Survey of International & Comparative Law* Volume 10 Issue 1 (2004) fq. 1-26, në fq. 24-25.

249 Sa i përket anës faktike, shpallja **non liquet** ka qenë e ndaluar, siç ka qenë e ndaluar dhënia e ndihmës gjyqtarit romak në çështjet e faktit. Kjo praktikë është ndërprerë në vitin 543 nga perandori **Justinian**, i cili me ediktin **Novella 125 De iudicibus** ka ndaluar dhe ndëshkuar shpalljen *non liquet* të gjyqtarëve. Ibid., fq. 15 & 22-23.

250 Ibid., fq. 1-11.

që supozohet se në shkallë të parë dhe të fundit mbron supremacinë (epërsinë) e Kushtetutës. Kjo gjendje mund të vazhdojë vetëm deri në hyrjen e Kosovës në **KE** dhe, për pasojë, nën juridiksionin e **Gjykatës së Strasburgut**. Vetëm atëherë do të shihen përmasat e vendimmarrjes së sotme të **Gjykatës Kushtetuese**. Deri atëherë, shkenca duhet ta thotë fjalën e vet.

Shënojmë për fund se në ndërkohën e përfundimit të këtij shkrimi, edhe dy raste të tjera janë vendosur nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës dhe janë tërësisht identike më katër rastet që i diskutuam këtu. Kjo tregon se trendi i zbatimit arbitrar të standardit të njëjtë vazhdon.[251]

16.15. Komente dhe pyetje

16.13.1. Në rastin e **RTK**, Gjykata Kushtetuese ka vendosur lidhur me masën e përkohshme. Cilat kanë qenë cilësitë kryesore të këtij vendimi?

16.13.2. Në rastin e **RTK**, dy gjyqtarë kushtetues kanë dhënë mendim mospajtues. Në mendimin e tyre mospajtues ata kanë theksuar, inter alia, arsyet që kanë të bëjnë me meritat e rastit. A kanë pasur të drejtë për një veprim të tillë? A mund të krijohet precedenti me vendimet për masën e përkohshme dhe, për pasojë, a mund të jepet mendimi mospajtues në masën e përkohshme? Nëse po, tregoni arsyet për një gjë të tillë!

16.13.3. Në rastin e ish-Presidentit **Fatmir Sejdiu**, Gjykata ka gjetur se ka pasur shkelje të Kushtetutës dhe se kjo shkelje ishte pasojë e një veprimi të vazhdueshëm që po e kryente ish-Presidenti **Fatmir Sejdiu**. Për çfarë bëhet fjalë këtu? Diskutoni!

16.13.4. Në rastin e ish-Presidentit **Fatmir Sejdiu** kishte ardhur deri te tërheqja e tre deputetëve nga kërkesa kundër tij. Gjykata Kushtetuese, megjithatë, kishte gjetur se kjo nuk mund të ndikonte fare në vendosjen e saj lidhur me kërkesën e parashtruar nga deputetët e Kuvendit të Kosovës. Cili ka qenë arsyetimi i mbrojtjes së ish-Presidentit **Sejdiu** dhe cili ka qenë arsyetimi i **Gjykatës Kushtetuese** lidhur me këtë? Diskutoni, por vetëm pasi ta keni studiuar aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese për këtë rast, të ndarë në grupe!

16.13.5. Cila ka qenë esenca e verdiktit të Gjykatës në rastin **Sejdiu**, përkatësisht cila shkelje kushtetuese është konstatuar me këtë rast?

16.13.6. Dy mendime mospajtuese u paraqitën në këtë rast. Cilat ishin pikat kyçe që u trajtuan në këto dy mendime mospajtuese në rastin **Sejdiu**? Diskutoni!

16.13.7. Në rastin **Pacolli**, dy gjyqtarë kushtetues kanë paraqitur mendim mospajtues. Cila ka qenë esenca e mendimit të tyre mospajtues?

16.13.8. Me një argument të tipit **këmbët e karriges**, të cilin ju duhet ta sqaroni gjatë diskutimit të rastit, Gjykata tha se në rastin **Pacolli** vendimi i saj nuk kishte efekt prapaveprues (**ex tunc**). Diskutoni kontekstin e këtij konstatimi të Gjykatës, në veçanti duke e krahasuar me mendimin mospajtues të dy gjyqtarëve kushtetues!

16.13.9. Gjykata Kushtetuese ka gjetur se është jo kushtetues çdo veprim, përmes amendamentit ose në ndonjë mënyrë tjetër, që synon në ndërprerjen e parakohshme të mandateve ekzistuese kushtetuese, duke përfshirë mandatin e ish-Presidentes **Atifete Jahjaga.** Shkarkoni nga ueb faqja e **Gjykatës Kushtetuese** aktgjykimin për këtë rast dhe gjeni argumentet kryesore të përdorura nga Gjykata me rastin e vendosjes

---

[251] *Rasti KI 84/19. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Merita Ramadani. Kërkesë për vlerësimin e Aktvendimit të Gjykatës se Apelit Ae. Dr. 279/18, te 30janarit 2019.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtinë, më 9 dhjetor 2019 Nr. ref.: R.K 1476/19. Paragrafët: 35-38; dhe *Rasti KI 39/19. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Raif Maloku. Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë se Aktvendimit te Gjykatës së Apelit, AC. nr. 4981/2017, të 15 majit 2018.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtinë, më 18 shkurt 2020 Nr. ref.: RK 1516/20. Paragrafët: 43-46.

së rastit. Në veçanti tregoni se çfarë lloj argumentesh ka përdorur Gjykata me këtë rast dhe cilat janë dy gjetjet kryesore pse amendamenti i anuluar ka qenë jo kushtetues.

16.13.10. Ekzistojnë disa qëndrime të **Dhomës së Posaçme** që preknin esencën e dy pushteteve kushtetutëbërëse: në rend të parë, ato preknin **pouvoir constitutant originaire** të **Kosovës**, ashtu siç u deklarua ai vullnet më 17 shkurt 2008 përmes **Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës**, autorë të së cilës ishin përfaqësuesit e zgjedhur të popullit të Kosovës; dhe, në rend të dytë, ato preknin edhe vetë esencën e mënyrës së ushtrimit të autoritetit shtetëror nga ana autoriteteve të reja kosovare të themeluara në mënyrë të rregullt pas shpalljes së pavarësisë (pengimi i ushtrimit të **pouvoir** *constitué* **originaire** nga ana e organeve të zgjedhura sipas Kushtetutës). Këto dy aspekte kanë shërbyer si njëra ndër bazat e arsyetimit të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, me të cilin është anuluar vendimi i **Dhomës së Posaçme** që ngërthente dy qëndrimet e sipërcekura. Ky aktgjykim ka pasur ndikim të madh në kornizimin e pushtetit ndërkombëtar në Kosovë në kohën e pavarësisë së mbikëqyrur. Diskutoni!

16.13.11. Në rastin e njohur si rasti **VLAN** apo **rasti ngërçit**, Gjykata Kushtetuese ka vendosur se kush është fitues dhe kush humbës në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014. Përveç kësaj, Gjykata ka vendosur disa standarde lidhur me procedurën kushtetuese që duhet ndjekur me rastin e formimit të organeve qendrore. Për këtë qëllim ka përdorur një strukturë argumentuese më të ndryshme nga ato që zakonisht përbëjnë standard argumentimi në Gjykatën Kushtetuese. Për çfarë strukturë argumentuese bëhet fjalë këtu? Merrni dy aktgjykimet në rastin **VLAN** apo në **rastin e ngërçit** dhe analizoni me kujdes, duke gjetur paragrafët relevantë në të cilët reflektohet përdorimi i **strukturës argumentuese dialoguese**.

16.13.12. Sipas Kushtetuese së vitit 2008, Kosova ka një sistem zgjedhor proporcional me lista të hapura. Kuptimi i fjalës "shumicë" për qëllimet e formimit të organeve qendrore shtetërore pas zgjedhjeve nacionale definohet në mënyrë shumë të qartë në Kushtetutë: "shumicë" konsiderohet ajo parti ose ai koalicion që ka marrë pjesë në zgjedhjet e përgjithshme dhe fiton më së shumti ulëse në Kuvend të Kosovës. Në të njëjtën kohë, një gjë e tillë nënkupton tri gjëra, të cilat janë si vijon:

- *e para*, shumicat në kuptimin e mësipërm nuk mund të formohen në ndërkohën e certifikimit të zgjedhjeve e deri të inaugurimi (formimi) i organeve të reja shtetërore, bazuar në rezultatin zgjedhor;
- *e dyta*, asnjë aleancë apo koalicion i ri jashtë atij të formuar si ofertë për zgjedhësin, mbi bazën e të cilit është hedhur vota ne zgjedhje, nuk mund të përmbysë rezultatin që ka dalë nga zgjedhjet ashtu që edhe trupat e ri shtetëror formohen duke u bazuar në këtë rezultat; dhe
- *e treta*, që mandati për të formuar qeverinë dhe për të pasur kryetarin e Kuvendit të Kosovës duhet dhënë partisë apo koalicionit që ka fituar në kuptimin si më sipër, përkatësisht që ka fituar shumicën e ulëseve në Kuvendin e Kosovës në krahasim me partitë apo koalicionit tjera që kanë marrë pjesë në zgjedhjet nacionale.

Këto tri postulate të Kushtetutës, për aq sa ato kanë të bëjnë me formimin e trupave qendror të pushtetit (Kuvendit dhe Qeverisë) u sfiduan nga opozita, e përbërë nga partitë: **LVV** (Lëvizja Vetëvendosje), **LDK** (Lidhja Demokratike e Kosovës), **AAK** (Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës) dhe **NISMA** (Nisma për Kosovën). Për këtë arsye edhe akronimi **VLAN**. Cila ka qenë esenca e pozicioneve të VLAN-it lidhur me zgjedhjet e qershorit 2014? Cila ka qenë përgjigja e Gjykatës Kushtetuese e dhënë në dy aktgjykimet e saj lidhur me zgjedhjet e qershorit 2014 dhe mënyrën e forumit të organeve qendrore pas këtyre zgjedhjeve?

16.13.13. Kontrolli kushtetues i **Marrëveshjes së Dytë** ngre një sërë çështjet të rëndësishme të së drejtës kushtetuese kosovare, siç janë: vendi dhe roli në sistemin kosovar i marrëveshjeve ndërkombëtare të pa ratifikuara nga Kuvendi, statusi i detyrimeve të marra ndërkombëtare nga ana e autoriteteve publike të Kosovës, por të cilat nuk janë shpallur në **gazetë zyrtare**, si dhe caqet e

kontrollit kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare në përgjithësi, pra edhe atyre të ratifikuara. Këto çështje kanë rëndësi për shkak se juridiksioni i **Gjykatës Kushtetuese**, deri vonë, ka qenë pa kufi në rast se Presidenti apo Qeveria e Kosovës vendosnin për të ngritur një çështje kushtetuese pranë saj. Diskutoni deri kur ka ekzistuar kjo praktikë dhe si është ndërprerë nga ana e Gjykatës Kushtetuese?

16.13.14. Gjykata Kushtetuese ka pasur një rast ideal për të sqaruar dhe saktësuar juridiksionin e saj kur bëhet fjalë për ngritjen e "çështjeve kushtetuese" nga Presidenti dhe nga Qeveria, por edhe për të vënë bazat e një kontrolli kushtetues të balancuar, kur bëhet fjalë për detyrimet ndërkombëtare të marra në mënyrë të vlefshme nga ana e organeve kushtetuese kosovare. Lëshimi i këtij rasti vështirë se mund të rikuperohet në të ardhmen kur Statuti i **AKS** të vijë për kontroll kushtetues në Gjykatën Kushtetuese, sërish mbi bazën e ngritjes si çështje kushtetuese nga ana e Qeverisë, pra jo siç është paramenduar me **Marrëveshjen e Dytë**. Në paragrafin 21 ["Dispozitat e përgjithshme dhe përfundimtare"] të **Marrëveshjes së Dytë**, është thënë si vijon:

"Statuti i Asociacionit/Bashkësisë do të hartohet nga Ekipi Menaxhues dhe do të paraqitet në Dialogun e Nivelit të Lartë brenda 4 muajsh nga dita e arritjes së marrëveshjes së këtyre parimeve elementeve, me lehtësim sipas nevojës, duke përfshirë atë të Ministrisë së Qeverisjes Lokale. Statuti do të vërtetohet me dekret pas marrëveshjes në Dialog. Cilido amendament që do të prezantohet nga Asociacioni/Bashkësia do të vërtetohet me dekret dhe do të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese".

Nga ky formulim, qartë shihet se këtu kemi të bëjmë me juridiksion shtesë të Gjykatës Kushtetuese në kuptim të nenit 113.10 të Kushtetutës. Diskutoni!

16.13.15. Rasti **Bankës Rajfajsen** ("Reifeisen Bank") është zgjedhur me aktvendim, me të cilin Gjykata ka vërtetuar një vendim të **Gjykatës Supreme të Kosovës**. Me çfarë ka pasur të bëj ky rast? Cila është rëndësia e tij për qytetarët e Kosovës? Çfarë do të ndodhte nëse Gjykata do ta kishte prishur vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës?

16.13.16. Kërkesa e ish-Presidentes **Atifete Jahjaga** lidhur me Marrëveshjen e Dytë u dorëzua në Gjykatën Kushtetues më 31 tetor 2015. Me të kërkohej që Gjykata të përgjigjej në pyetjen si vijon:

"Duke marrë parasysh se Parimet e Asociacionit rregullojnë krijimin dhe funksionimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë, a janë në përputhshmëri këto parime dhe elemente me frymën e Kushtetutës, neni 3, paragrafi 1 (natyra shumetnike), me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës?".

Çfarë do të thotë kjo? Cili *ë*shtë kuptimi i kësaj kërkese?

16.13.17. Në **Evropë**, për momentin, ekzistojnë tri lloje të sistemeve juridiko-kushtetuese që përcaktojnë vendin dhe rolin e traktateve ndërkombëtare në sistemin e brendshëm. Në disa shtete, kushtetutat nacionale u japin një status special, në veçanti kur flitet për traktatet nga fusha e të drejtave të njeriut; në disa të tjera, traktatet kanë statusin ndërmjet kushtetutës dhe ligjit; dhe, së fundi, në disa vende evropiane, traktatet e të gjitha llojeve, me kushtetutë nacionale, gëzojnë statusin e ligjit të zakonshëm. Këtu bën përjashtim **Holanda**, e cila i jep një primat absolut të drejtës ndërkombëtare, pa marrë parasysh burimin e saj (traktat, zakon ndërkombëtar apo burim tjetër i të drejtës ndërkombëtare). Ku bën pjesë Kosova me sistemin e saj juridik – kushtetues?

16.13.18. Kushtetuta e vitit 2008 e ka përcaktuar qartë një standard të marrëdhënies në mes të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe ligjeve kosovare, duke ua njohur të parave statusin më të ulët se Kushtetuta e më të lartë se ligji i zakonshëm. Ky standard i vënë kësisoj nënkupton që çdo normë, e cila bie ndesh më një normë ndërkombëtare kontraktuale, shfuqizohet në momentin e hyrjes në

fuqi të kësaj të fundit. Tani këtu shtrohet pyetja nëse një status të tillë juridiko-kushtetues e kanë vetëm marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga **Kuvendi i Kosovës** (ratifikimi i brendshëm), në kuptim të nenit 18. 1 të Kushtetutës, apo çdo marrëveshje tjetër ndërkombëtare, pa marrë parasysh llojin e ratifikimit, siç përcaktohet në nenin 18.2 të Kushtetutës? Diskutoni!

16.13.19. Sot ekzistojnë marrëveshje ndërkombëtare që lidhen në mënyrë të vlefshme sipas dispozitave të **KVDT**, përkatësisht sipas standardeve të së drejtës zakonore ndërkombëtare, por të cilat nuk i nënshtrohen ratifikimit të brendshëm. I tillë është rasti edhe me **Marrëveshjen e Dytë**, e cila në pikëpamje të së drejtës ndërkombëtare zakonore ka statusin e marrëveshjes së lidhur në vazhdim të zbatimit të qëllimeve dhe të objektit të **Marrëveshjes së Parë**. Nga aspekti i të drejtës së brendshme, ndërkaq, **Marrëveshja e Dytë** ka karakter të **normëvënies implementuese** që administron mënyrën e zbatimit dhe detajet e tjera që lidhen me vënien në jetë të **Marrëveshjes së Parë**. Lidhja e **Marrëveshjes së Dytë**, sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare është e barabartë me ratifikimin ndërkombëtar. Tregoni arsyet për këtë!

16.13. 20. Marrëveshjet nga nenit 18.1 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] i Kushtetutës nuk i nënshtrohen kontrollit kushtetues nga ana e **Gjykatës Kushtetuese**, si pasojë e faktit se standardi i kontrollit kushtetues të marrëveshjeve të tilla është shumë i rreptë dhe nuk lejon gjykatat kushtetuese të ndërhyjnë në komunikimin ndërkombëtar të shteteve, të cilat, nëse do ta kishin një të drejtë të tillë, atëherë do ta luanin rolin e një gjykate ndërkombëtare kushtetuese. Këtë pozitë e ka mbrojtur edhe **Gjykata Kushtetuese** në aktgjykimin e saj lidhur me kontrollin kushtetues të **Marrëveshjes së Parë**. Çfarë ka thënë Gjykata? Diskutoni!

16.13.21. Në **Evropë** ekzistojnë shtete, të përmendura edhe aktgjykimin e Gjykatës lidhur me **Marrëveshjen e Parë**, të cilat njohin të drejtën e kontrollit preventiv të marrëveshjeve ndërkombëtare. Çka nënkuptohet me këtë lloj të kontrollit kushtetues dhe cilat vende kanë një sistem të tillë të kontrollit kushtetues?

16.13.22. Në një raport të **Komisionit të Venecias**, duke iu referuar **Maqedonisë së Veriut**, ka vërtetuar standardin ndërkombëtar të mishëruar në **KVDT**, sipas të cilit marrëveshjet ndërkombëtare që nuk ratifikohen nga parlamenti janë pjesë përbërëse e rendit të brendshëm juridik dhe gjejnë zbatim të njëjtë si dhe ato të ratifikuarat, në vartësi të natyrës së normave që prodhojnë (të vetëzbatueshme ose jo). Kjo është kështu për shkak se marrëveshjet e lidhura, të cilat përmbajnë norma të tilla, zakonisht administrojnë normat e marrëveshjes së ratifikuar me qëllim të saktësimit dhe të implementimit të tyre. Normat e përmbajtura në marrëveshjet administrative lindin si pasojë e ekzistimit të dy rrethanave. Diskutoni!

16.13.23. Siç mund të vërehet nga diskutimi i mësipërm, në Kushtetutë nuk ekziston qoftë dhe një dispozitë që flet për mundësinë e lejimit të kontrollit kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare, pa marrë parasysh nëse janë ratifikuar ose jo nga Kuvendi, nga Presidenti i Republikës apo nga Qeveria. Në fakt, mundësinë e ratifikimit të llojeve të caktuara të marrëveshjeve ndërkombëtare nga ana e Presidentit të Republikës e lejon shprehimisht paragrafi 2 i nenit 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës. I njëjti nen, por edhe tërë Kushtetuta, ngelen të heshtur sa i përket ratifikimit të llojeve të caktuara të marrëveshjeve ndërkombëtare nga ana e Qeverisë. Kjo nënkupton se çdo ratifikim që kryhet nga Qeveria duhet të bëhet me autorizim të Presidentit të Republikës, me kusht që fjala nuk është për marrëveshjet nga neni 18.1 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] i Kushtetutës. Nga aspekti ndërkombëtar, ndërkaq, vlen të theksohet e të sqarohet se, edhe pa këtë autorizim të Presidentit të Republikës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Qeveria janë të vlefshme, gjë që nënkupton se paqartësitë kushtetuese nga neni 18.2 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] i Kushtetutës nuk mund të shpërbejnë si bazë për mohimin e detyrimeve të marra ndërkombëtare. Atëherë, si ndodhi që **Marrëveshja e Dytë** u bë objekt kontrolli kushtetues në **Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës**? Përgjigja në këtë pyetje gjendet në historikun e zgjerimit të juridiksionit të **Gjykatës**, që ka ndodhur me **Aktgjykimin KO 80/10** të 7 tetorit 2010, në rastin e njohur si **Rasti Qeska.** Diskutoni!

16.13.24. Gjykata Kushtetuese i ka gjetur si jo kushtetuese dy konstatime të **Dhomës së Posaçme** sepse binin ndesh me parimin **res judicata**. Përveç kësaj, Gjykata ka theksuar se palët e interesuara, që kishin fituar rastin në vitin 2015, pra **Komuna e Deçanit** dhe dy ndërmarrjet shoqërore, asnjëherë nuk kishin kontestuar shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese pranë Gjykatës Kushtetuese, ani se kishin pasur një mundësi të tillë. Këtë nuk e kishte bërë as **AKP**, e cila kishte ngritur çështjen e subjektivitetit të vet juridik dhe mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese pranë **Gjykatës Kushtetuese**. Kjo rrethanë i ka mundësuar Gjykatës Kushtetuese që të arrij në konstatimin që thotë se **Dhoma e Posaçme** nuk të vendos për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të palëve të prekura përmes rikthimit të çështjes në rigjykim. Pse? Diskutoni!

16.13.25. Rasti i zgjedhjes së **Presidentit të Republikës** është krijuar në një situatë mjaft të tensionuar politike: deputetët nga opozita, **VV** (**Lëvizja Vetëvendosje**), **AAK** (**Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës**) dhe **NISMA** (**Nisma për Kosovën**) tërë kohën sa ka zgjatur zgjedhja kanë përdorur **gaz lotsjellës** dhe mjete të tjera jodemokratike për të penguar nisjen e procedurave të zgjedhjes. Kjo zgjedhje u bë pas mbarimit të mandatit të ish-Presidentes **Atifete Jahjaga** (7 prill 2011 – 7 prill 2016).

Vendimi i Gjykatës në këtë rast ka formën e aktvendimit, përkatësisht të vendimit jomeritor, me të cilin Gjykata ka shpallur kërkesën si qartazi të pabazuar për faktin se "[...] parashtruesit e kërkesës nuk i kanë dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tyre se vendimi i Kuvendit "[...] për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës... është në kundërshtim me nenin 86, paragrafët 4 dhe 5 të Kushtetutës." Diskutoni! Në veçanti tregoni llojin e argumenteve të përdorura nga Gjykata dhe a ka ardhur deri te ndryshimi i precedentit në rastin **Pacolli.**

16.13.26. Një defekt tjetër serioz përmbajtjesor i argumentit në vendim për rastin e KQZ lidhet me premisën tjetër, të dytën, ku Gjykata thotë se nuk është në natyrën e gjyqësisë kushtetuese të shqiptojë **mendime këshilluese,** përkatësisht të marr rol **konsultativ apo këshillëdhënës**. Për më tepër, gjithnjë sipas Gjykatës, edhe në ato vende ku ka pasur një praktikë të tillë, ajo është braktisur pikërisht sepse nuk është në natyrën e gjyqësisë kushtetuese. Si argument për këtë të fundit përmendet **rasti gjerman**. Krejt kjo premisë është fiktive dhe me hamendje, tërësisht e paqëndrueshme dhe atë për dy arsye. Diskutoni!

16.13.27. Në **rastin e tentim-rrënimit të Gjykatës Speciale** vlejnë, **mutatis mutandis**, të gjitha ato që janë thënë në rastin e **KQZ**: Gjykata edhe këtu shpërfaq mungesë të dijes profesionale lidhur me konceptet themelore të interpretimit dhe zbatimit të Kushtetutës, si dhe lidhur me dallimin në mes të kontrollit kushtetues (**constitutional reviw**) dhe kontrollit gjyqësor (**judicial review**). Në shtjellimet e veta në këtë rast, Gjykata ka shkuar një hap më tutje në shpërndarjen e mosnjohjes së gjërave themelore rreth kontrollit kushtetues **preventiv (ex ante)** dhe **represiv (ex post),** duke përdorur termat **ex ante** dhe **ex post** në një kontekst tërësisht të pavend dhe që nuk ka asnjë lidhje me **konfliktin për kompetencë**. Diskutoni!

16.13.28. Kjo, megjithatë, nuk është e tëra: **kërkesa për konflikt për kompetencë kushtetuese** nuk përbën **kërkesën origjinale** me të cilën është vënë në lëvizje Gjykata Kushtetuese në **rastin e tentim rrënimit të Gjykatës Speciale**. Në fillim ka qenë një kërkesë krejtësisht tjetër nga ana e Presidentit: kërkesa për konflikt për kompetence është bërë pas një **ftese** që vetë Gjykata i ka bërë **Presidentit të Republikës** për ta ridefinuar kërkesën fillestare të paraqitur në bazë në nenit 84.9 të Kushtetutës. Në ndërkohë që Gjykata ke vendosur rastin e **KQZ**, duke e ndërprerë në mënyrë arbitrare dhe jo profesionale një praktikë të sajën të mëparshme, më pas, vetë ajo e ka ftuar me letër Presidentin që ta ridefinojë, nëse do, të njëjtën kërkesë sipas parametrave të tjerë juridiksional që lidhen me **konfliktin për kompetencë** kushtetuese nga neni 113. 3 (1) ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] i Kushtetutës. Diskutoni rrethanat e krijimit të kësaj situate dhe si është zgjidhur në fund!

16.13.29. Rastet e vendimmarrjes së **Gjykatës Kushtetuese** lidhur me çështjen e përsëritjes së procedurës shpërfaqin në mënyrë edhe më të dukshme mosnjohjen nga ana e saj të disa aspekteve që kanë të bëjnë me dy aspekte, të cilat janë për sa vijon:

- e para, mosnjohjen e rolit dhe pozitës së **GJEDNJ** dhe të **KEDNJ** si një traktat ndërkombëtar që ngërthen zotime të shteteve anëtare për respektimin e të cilave kujdeset vetë **GJEDNJ**; dhe
- e dyta, mosnjohjen e marrëdhënies në mes të **GJEDNJ** dhe gjykatave kushtetuese nacionale të vendeve anëtare të saj (ku hyjnë edhe gjykatat e larta nacionale që kryejnë funksionet e gjykatës kushtetuese).

Diskutoni këto dy aspekte dhe si janë reflektuar këto në vendimmarrjen e Gjykatës në rastet e njohura si **rastet e përsëritjes së procedurës!**

16.13.30. Sa i përket rolit dhe pozitës së **GJEDNJ** në sistemin evropian të drejtësisë, vlen të theksohet se ky institucion ka statusin e një gjykate ndërkombëtare, e cila është themeluar me anë të një traktati, që quhet **KEDNJ**. Funksioni klasik dhe primar i **GJEDNJ** ka qenë dhe ngelet ai i mbikëqyrjes së zbatimit të **KEDNJ** dhe zotimeve të marra aty nga ana e shteteve anëtare, kurse me kalimin e kohës ka marr mbi vete, nga viti 1988, edhe një funksion tjetër – funksionin kushtetues sa i përket lirive dhe të drejtave të njeriut të garantuara me **KEDNJ.** Ky funksion kushtetues konsiston në vënien e standardeve dhe krijimin e një niveli minimal të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave nga **KEDNJ** në nivel të krejt Evropës. Diskutoni këto funksione dhe si reflektohen këto në gabimet e Gjykatës Kushtetuese në rastet e **përsëritjes së procedurës**!

16.13.31. Realizimi i funksionit kushtetues të **GJEDNJ** nuk mund të jetë i njëjtë me atë që kryejnë gjykatat nacionale sepse ekzistojnë disa parime dhe doktrina që i ka zhvilluar **GJEDNJ** me qëllim të respektimit të sovranitetit të shteteve anëtare të **KEDNJ**. Këto parime dhe këto doktrina përbëjnë një kufizim substancial në hapësirën e veprimit të **GJEDNJ** kundrejt autoriteteve shtetërore nacionale të shteteve anëtare. Kjo është kështu sepse parimi i barazisë sovrane të shteteve kushtëzon një marrëdhënie shumë specifike në mes të **GJEDNJ** dhe autoriteteve kushtetuese nacionale, marrëdhënie që nuk ekziston në mes të gjykatave kushtetuese nacionale dhe gjyqësorit të rregullt dhe organeve të tjera të pushtetit. Ndër parimet kufizuese që dalin si pasojë e barazisë sovrane të shteteve dhe të cilat i ka krijuar dhe zhvilluar **GJEDNJ** në komunikimin e saj me gjykatat kushtetuese dhe autoritetet e tjera nacionale janë: **parimi i subsidiaritetit** dhe **parimi i vlerësimit të lirë** (**margin of appreciation**). Diskutoni këto parime dhe si reflektohen këto në gabimet e Gjykatës Kushtetuese në rastet e **përsëritjes së procedurës**!

16.13.32. Nisur nga pozita që **KEDNJ** dhe **GJEDNJ** kanë në rendet juridike nacional, vendimet e kësaj të fundit në rendet nacionale evropiane nuk kanë fuqi të përgjithshme (**erga omnes**), por vetëm fuqi interpretuese (**res interpretata**) në procesin e vendimmarrjes në nivel nacional sa i përket lirive dhe të drejtave të garantuara me **KEDNJ**. Kjo është kështu sepse natyra juridike e vendimeve të **GJEDNJ** është deklarative ngaqë çdoherë **GJEDNJ** tregon se si duhet të adresohet cenimi i dispozitave të **KEDNJ** nga ana e shteteve anëtare dhe si të ofrohet satisfaksioni për palën viktimë të një cenimi të tillë. Diskuto këtë fakt në dritën e gabimeve të **Gjykatës Kushtetuese** në vendimmarrjen rreth çështjeve të **përsëritjes së procedurës**!

16.13.33. Shikuar nga aspekti i gjykatave nacionale dhe marrëdhënies së tyre me gjykatat e gjyqësorit të rregullt dhe me autoritetet tjera kushtetutshmërinë e të cilave e mbikëqyrin dhe kontrollojnë, subsidiariteti dhe liria e vlerësimit nuk kanë asnjë kuptim dhe nuk gjejnë vend për zbatim. Kjo për shkak se gjykatat kushtetuese në nivel nacional nuk janë në pozitën dhe rolin e **GJEDNJ.** Kjo e fundit, gjykuar sipas rolit dhe pozitës së saj të përcaktuar me **KEDNJ**, është krijuar për të respektuar sovranitetin dhe pavarësinë e shteteve anëtare duke ua caktuar atyre hapësirën minimale brenda s cilës ato duhet t'i vejnë në jetë dhe t'i implementojnë liritë dhe të drejtat e garantuara me te, gjithnjë duke respektuar standardet dhe substancën minimale të vendosur nga interpretimet e **GJEDNJ**. **Në asnjë rast, gjykata nacionale kushtetuese nuk mund të mbështetet në parimin e subsidiaritetit dhe në lirinë e vlerësimit për të përcaktuar vëllimin dhe cilësinë e lirive dhe të drejtave të garantuara kushtetuese**. Një gjë të tillë nuk mund ta bëj as duke u thirrur në këto

dy parime dhe doktrina ashtu siç ato vihen në jetë në nivel evropian nga ana e **GJEDNJ**, për faktin e thjesht se gjykatat nacionale kushtetuese nuk janë në pozitën e shteteve anëtare si shtete sovrane dhe të pavarura. Kjo vlen për çdo çështje kushtetuese që shtrohet për vendosje dhe shqyrtim pranë gjykatave nacionale. Diskutoni këtë si më sipër në kontestin e rasteve të cilat **Gjykata Kushtetuese** i ka cilësuar si **përsëritje e procedurës**, me fokus të veçantë në mënyrën se si Gjykata është substituar (zëvendësuar) në vend të **GJEDNJ**.

17. Lexim shtesë

- *Rasti K0 118/13. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues Albana Fetoshi dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit te Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 04/L-201 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-16s për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013.***Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës** Prishtinë, më 9 shtator 2013 Nr. Ref.: RK470/ 13;
- *Rasti KO 12/18. Aktgjykim. Parashtrues: Albulena Haxhiu dhe 30 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverise së Republikës së Kosovës, nr. 04/20, të 20 dhjetorit 2017*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtinë, më 11qershor 2018 Nr. ref.: AGJ 1258/ 18;
- *Mendim i Përbashkët Mospajtues i gjyqtareve Almiro Rodrigues dhe Gresa Caka Nimani në rastin K0 12/18. Parashtrues: Albulena Haxhiu dhe 30 deputete të tjera të Kuvendit të Republikës së Kosovës Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverise së Republikës se Kosovës nr. 04/20, të 20 dhjetorit 2017*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, më 11 qershor 2018 Nr. ref.: MPM 1278/18;

- *Rastet nr. KI 146/17, KI 147/17, KI 148/17, KI 149/17 dhe KI 150/17. Aktgjykim. Parashtrues: Isni Thaçi, Zeqir Demaku, Fadil Demaku, Nexhat Demaku, dhe Jahir Demaku. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. KZZ. nr. 322/2016, te 19 korrikut 2017*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 7 Qershor 2018. Nr. Ref.: AGJ 1248/18;

- *Rastet KI 176/18, KI 183/18 dhe KI 06/19. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Zeqir Demaku, Jahir Demaku, Fadil Demaku, Nexhat Demaku, Isni Thaçi, Bashkim Demaj, Selman Demaj, Driton Demaj dhe Agim Demaj. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 158/2018, të 26 shtatorit 2018.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtine, me 2 dhjetor 2019. Nr. ref.: RK 1471/19.

LITERATURA:

A. LIBRA:

- Abdullahi An-Na'im, *African Constitutionalism and the Role of Islam* (University of Pennsylvania Press: Philadelphia: 2000);
- Adam Czamota, Martin Krygeier and Wojciech Sadurski (eds.), *Rethinking the Rule of Law After Communism* (CEU Press: Budapest, 2005);
- Tom Campbell, K.D. Ewing, and Adams Tomkins, *The Legal Protection of Human Rights. Skeptical Essays* (Oxford University Press: Oxford, 2011);
- Adem Beha and Bekim Baliqi, *2014 Elections in Kosovo: A Retrospective* (Department of Political Science of the University of Prishtina "Hasan Prishtina", Pristina, 2014);
- Ahron Barak, *Proportionality. Constitutional Rights and Their Limitation* (Cambridge University Press: Cambridge, 2012);
- Albert H. Y. Chen (ed.), *Constitutionalism in Asia in Early Twenty – First Century* (Cambridge University Press: Cambridge, 2014);
- Alex N. Dragnich, *The First Yugoslavia: Search for a Viable Political System* (Hoover Institution Press: Stanford, California, 1983);
- Allan Brewer – Carias, *Constitutional protection of Human Rights in Latin America. A Comparative Study of Amparo Proceedings* (Cambridge University Press: Cambridge, 2009);
- Allan R. Brewer–Carias (ed.), *Constitutional Courts as Positive Legislators. A Comparative Law Study* (Cambridge University Press: Cambridge, 2011);
- Allan R. Brewer–Carias (ed.), *Positive Courts as Positive Legislators. A Comparative Law Study* (Cambridge University Press: Cambridge, 2011);
- Allan Rosas and Lorna Armati, *EU Constitutional Law. An Introduction* (Hart Publishing: Oxford and Portland, Oregon: 2018);
- Ana S. Trbovich, *A Legal Geography of Yugoslavia's Disintegration* (Oxford University Press: Oxford, 2008);
- Luca Mezzeti, *Sistemi e Modeli di Giustizia Costituzionale*. Tomo I (CEDAM: Padova, 2009);
- Andras Jakab, Arthur Dyevre and Giulo Itzovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* (Cambridge Unioversity Press: Cambridge, 2017);
- Andrea Lorenzo Capussela, *State – Building in Kosovo. Democracy, Corruption and the EU in the Balkans* (I.B. Tauris: London and New York, 2015);
- Andrea Lorenzo Capussela, *State – Building in Kosovo. Democracy, Corruption and the EU in the Balkans* (I.B. Tauris: London and New York, 2015);
- Andrew Harding and Peter Leyland (eds.), Constitutional Courts. A Comparative Study (Wildy, Simmonds & Hill Publishin: London, 2009);
- Andrzej Szmyt and Boguslav Banaszak (eds.), *The Transformation of Law Systems in Central, East European and Southeastern Europe in 1989-2015. Liber Amicorum in Honorem Prof. Dr. DRES. H.C. Rainer Arnold* (Gdansk University Press: Gdansk, 2015);
- Anna Fruhstorfer and Michael Hein (eds.), Constitutional Politics in Central and Eastern Europe. From Post-Socialist Transition to the Reform of Political Systems (Springer: Wiesbaden, 2016);
- Anneli Albi, *EU Enlargement and the Constitutions of Central and Eastern Europe* (Cambridge University Press: Cambridge, 2005);
- *Ante Romac, Rječnik* latinskih *pravnih izraza*. *Vademecum iuridicum* (Informator: Zagreb, 1985);
- Anton Bebler dhe Jim Seroka (eds.), *Contemporary Political Systems: Classifications and Typologies* (Lynne Reinner Botues: Boulder and London, 1990);
- Antonello lo Calzo, "PROTOSISTEMI DI GIUSTIZIA COSTITUZIONALE: IL CORPO

DEGLI EFORI NELLA COSTITUZIONE DELLA REPUBBLICA NAPOLETANA DEL 1799"/"EARLY SISTEMS OF CONSTITUTIONAL ADJUDICATION: THE COUNCIL OF THE EPHORS IN 1799 NEAPOLITAN REPUBLIC CONSTITUTION"*HISTORIA CONSTITUCIONAL* num. 14 (Septiembre, 2013);

- Antonio Cassese, "Modern Constitutions and International Law". *Collected Courses of the Hague Academy of International Law* 192 (Leiden/Boston: Brill/Nijhoff, 1985);
- Antony Best, Jussi Hanhimaki, Joseph A. Maiolo, Kirsten E. Schulze, *International History of the Twentieth Century and Beyond* (Routledge: New York, 2015);
- Anthony Aust, *Modern Treaty Law in Practice* (Cambridge University Press: Cambridge, 2000);
- Anver M. Emon and Rumee Ahmed (ed.) *The Oxford Handbook of Islamic Law* (Online Publication Date: Nov 2015 DOI: 10.1093/ oxfordhb /97801996 79010. 013.27);
- Arend Lijphart (ed), *Conflict and Coexistence in Belgium: the Dynamics of a Culturally Divided Society*. (Institute of International Studies. University of California: Berkely, 1981);
- Arend Lijphart (ed), Parliamentary versus Presidential Government (Oxford University Press: Oxford, 1992);
- Arend Lijphart, *Patterns of Democracy. Government forms and Performance in Thirty-Six Countries* (Yale University Press: New Haven and London, 1999);
- Arend Lijphart, *The Politics of Accommodation: Pluralism and Democracy in the Netherlands*. (University of California Press: LA, 1968);
- Arend Lijphart, *Thinking about Democracy. Power-sharing and Majority Rule in Theory and Practice*. (Routledge: New York, 2008);
- Arne Marcic, The Constitutional review. Second Edition (Vendeplas Publishing, LLC: USA, 2011-2013);
- Arne Marjan Mavčič (ed.), *Constitutional Review Systems Around the World* (Vandeplas Publishing: USA, 2018;
- Arne Marjan Mavčič (ed.), Constitutional Review Systems Around the World (Vandeplas Publishing: USA, 2018);
- *Arne Marjan Mavčič*, *P.E*, *editor, Constitutional Review Systems Around the World* (Vandeplas Publishjinge, LL.C.: USA, 2019);
- Arne Mavcic, The Constitutional Review. Second Edition (Vandeplas Publishing, LLC: USA, 2013);
- Arthur Dyevre and Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* (Cambridge University Press: Cam bridge, 2017);
- Aurela Anastasi, *E Drejta Kushtetuese e Krahasuar* (Shtëpia Botuese "Dajti 2000": Tiranë, 2009);
- Barthold Georg Niebuhr, *The History of Rome. Volume Third* (Lea & Blanchard, 1844);
- Benjamin Isakhan and Stephen Stockwell (eds.), *The Edinburgh Companion to the History of Democracy. From Pre-History to Future Possibilities* (Edinburgh University Press: Edinburgh, 2015);
- Benjamin Isakhan and Stephen Stockwll (eds.), *The Edinburgh Companion to the History of Democracy. From Pre-Hsitory to Future Possibilities* (Edinburgh University Press: Edinburgh, 2015);
- Boris Krivokapić, *Enciklopedijski rečnik medjunarodnog prava i medjunarodnih odnosa* (JP Službeni Glasnik: Beograd, 2010);
- Bosa Nenadic (ed.), *USTAVNI SUD REPUBLIKE SRBIJE 1963-2008* (Sluzbeni glasnik: Beogrda, 2009);
- Branimir M Jankovic, *The Balkans in International Relations* (Mcmillan Press: London, 1988);
- Branko Smerdel, *USTAVNO UREDENJE EUROPSKE HRVATSKE* (NARODNE NOVINE: Zagreb, 2011);

- Brian Barnwell, *Constitutional Law in the People's Republic of China. Chinese Law Paper Series* (Government Law Center of Albany Law School: Albany, NY, 2011);
- Carl Schmitt, "Der huter der verfasung". A*rchiv des offentlichen rechts*. Neue Folge 16 Band J.C.B. Mohr (Paul Siebeck), Tubingen 1929);
- Carl Schmitt, *Constitutional Theory* (Duke University Press: Durham and London, 2008);
- Carl Schmitt, *On the Three Types of Juristic Thought* (Preager: USA, 2004);
- Carl Schmitt, *Political Theology. Four Chapters on the Concept of Sovereignty* (The University of Chicago Press: Chicago, 1985);
- Carl Schmitt, *The Nomos of the Earth in the International Law of the Jus Publicum Eurpeaum* (Telos Press Publishin: USA, 2006);
- Carl Shcmitt, *Dicatorship* (Polity Press: UK and USA, 2014);
- Cass R. Sunsstein, *Designing Democracy: What Constitutions Do* (Oxford University Press: Oxford, 2001);
- Charles A. Gulick, *Austria from Habsburg to Hitler. Vol. II. Fascism's Subversion of Democracy* (University of California Press, Berkeley and Los Angeles, 1948);
- Charles Eisenmann, *La justice constitutionnelle et la Haute cour constitutionnelle d'Autriche* (Librairie Générale de Droit & de Jurisprudence: Paris, 1928);
- Charles M. Fombad, (ed.), *Separation of Powers in African Constitutionalism* (Oxford University Press: Oxford, 2016);
- Chistopher Wolfe, *The Rise of Modern Judicial Review. From Constitutional Interpretation to Judge Made Law* (Littlefield Adams Quality Paperbacks: USA, 1994);
- Alberto Febbrajo and Giancarlo Corsi (eds.), *Sociology of Constitutions. A Paradoxical Perspective* (Routledge: London and New York, 2016);
- Christian W. Haerpfer, Patrick Bernhagen, Ronald F. Inglehart, Christian Welzel (eds.), *Democratization*. Second Edition (Oxford University Press: Oxford 2019);
- Colm O'Cinneide, *Human rights and the UK constitution September* (The British Academy: London, 2012);
- Constance Grewe, Oliver Jounjan, Eric Maulin, Patric Wachsmann (eds.), *La notion de"justice constitutionnelle"*(Dalloz: Paris, 2005);
- Csongor Kuti, *Post-Communist Restitution and the Rule of Law* (Central European University: Budapest/New York: 2009);
- Czeslaw Milossz, *Mendja e robëruar. Ese mbi logogracitë popullore* (1953);
- Daniella Biella, *Manipolazione e interpretazione della Corte costituzionale in due sektori emblematici del diritto penale: la giustizia minorile e la giustizia militare* (Universita degli studi di Milano: Milano, 2010/2011);
- David Weissbrodt and Connie de la Vega, *International Human Rights. An Introduction* (University of Pennsylvania Press: Philadelphia, 2007);
- Dawn Oliver and Carlo Fusaro (eds.), *How Constitutions Change. A Comparative Study.* (Hart Publishing. Oxford and Portland, Oregon, 2011);
- Dejan Jović, *Yugoslavia: A State* Press *that Withered Away* (Purdue University Press: West Lafayette, Indiana, 2009);
- Dimitar Bechev, *Rival Power. Russia's Influence in South East Europe* (Yale University Press: New Haven and London, 2017);
- Dimitrije Kulic, *USTAVNO SUDSTVO U SVETU* ("Nasa Rec": Leskovac, 1972);
- Dimitrije Kulic, *Ustavno sudstvo u svetu*. Drugo Izdanje (Leskovac, 1972);
- Dinah Shelton (ed.), *International Law and Domestic Legal Systems. Incorporation, Transformation, and Persuasion* (Oxford University Press: Oxford, 2011);
- Domingo García Belaúnde & D. Fernández Salgado (eds.), *La jurisdicción constitucional en Iberoamérica* (Dykinson: Madrid, 1977);
- Donald P. Kommers, *The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany*.

Second Edition (Duke University Press: Durham and London, 1997);
- Donald Quataret, *The Ottoman Empire 1700-1922* (Cambridge University Press: Cambridge, 2005);
- Dr. J. N. Pandey, *The Constitutional Law of India*. 47th Edition (CLA: ALLAHABAD, India, 2010);
- Dr. Jovan Gjorgjeviq*, E DREJTA KUSHTETUESE* (Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës: Prishtinë, 1972);
- Dragan M. Stojanovic, *USATAVNO PRAVO.* Knjiga I (Bona Fides: Nis, 2001);
- E. Villiger, *Commentary on the 1969 Vienna Convention on the Law of Treaties* (Martinus Nijhoff Publishers: Leiden and Boston, 2009);
- Edouard Lambert, *Le gouvernement des juges et la lutte contre la législation sociale aux États-Unis. L'expérience américaine du contrôle judiciaire de la constitutionnalité des lois* (Girard & Cie: Paris, 1921);
- Eduardo Gianfrancesco, Nicola Lupo, and Guido Rivosecchi (eds.), *I Presidenti di Assamblea parlamentare* (Il Mulino: Bologna, 2014);
- Eduardo Rozo Acona e Paola Maffei, *LE COSTITUZIONI DELL'AMERICA LATINE. I PAESI DELLA COMMUNITA ANDINA* (G. GIAPPICHELLI EDITORE: TORINO, 2006);
- Edward Said, *Orientalism* (Vintage Books: New York, 2017);
- Edward Samuel Corwin, *The Doctrine of Judicial Review. Its Legal and Historical Basis, and Other Essays [1914]* (Princenton University Press: Princeton, 1914);
- Elena Malfati, Saulle Panizza, Roberto Romboli, *GIUSTIZIA COSTITUZIONALE* (G. GIAPPICHELLI EDITORE: TORINO, 2013);
- Elliot Bulmer, Judicial Tenure, Removal, Immunity and Accountability (International Institute for Democracy and Electoral Assistance/ International IDEA: Stockholm, 2017);
- Enver Hasani & Ivan Cukallovic, *Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Komentar* (GIZ: Prishtinë, 2013);
- András Jakab, Arthur Dyevre and Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* (Cambridge University Press: Cambridge, 2017);
- Erin Delaney and Rosalind Dixon, *Comparative Judicial Review* (Edward Elgar: UK & USA, 2018);
- Erin F. Delaney & Rosalind Dixon (eds.), Comparative Judicial Review. Research Handbooks in Comparative Constitutional law Series (Edward Elgar Pub: United Kingdom, 2018);
- Erin F. Delaney and Rosalind Dixon (eds.), *Comparative Judicial Review*. (Edward Elgar Publishing: UK and USA, 2018);
- Ernest Baker (Ed. and Transl.), *The Politics of Aristotle* (Oxford University Press: Oxford, 1962);
- Erwin Chemerinsky, *Constitutional Law. Principles and Policies* (ASPEN: New York, 2006);
- Fatemah Alzubairi, *Colonialism, Neo-Colonialism, and Anti-Terrorism Law in the Arab World* (Cambridge University Press: Cambridge, 2019);
- Federal Judicial Center, *Recusal: Analysis of Case Law Under 28 U.S.C. §§ 455 & 144* (University Press of the Pacific, 2002) & Federal Judicial Center, *Judicial Disqualification: An Analysis of Federal Law* (144 (University Press of the Pacific, 2010);
- Franchesko Saverio Marini, *Appunti di GIUSTIZIA COSTITUZIONALE* (G. Giappichelli Editore: Torino, 2005);
- Franck C. Newman and David Wiessbrodt, *International Human Rights: Law, Policy, and Process* (Anderson Publishing Company: Cincinati, Ohio, 1996);
- Dörr, Oliver, Schmalenbach, Kirsten (eds.), *Vienna Connvention on the Law of Treaties. A Commentary* (SPRINGER: Verlag Berlin Heidelberg, 2012);
- *Franz Kafka, Vepra e plotë në prozën e shkurtër* nga Ardian Klosi (Dudaj: Tiranë, 2016);
- Gábor Halmai, *Perspectives on Global Constitutionalism. The Use of Foreign and Internation-*

al Law (Eleven International Publishing: The Hague, 2014);
- Gad Barzilai, Wars, Internal Conflicts, and Political Order (State University of New York Press: New York, 1996) ;
- *GAI Institvtiones or Institutes of Roman Law by Gaius*, with a translation and commentary by the late Edward Poste, M.S. (Oxford at the Clarendon Press: Oxford, 1904);
- Garry Jeffrey Jacobson, *Constitutional Identity* (The President and Fellows of the Harvard College: Harvard, 2010);
- Geoffrey Brennan and Jose Casas Pardo, A Reading of the Spanish Constitution (1978);
- George N. Sfeir, Modernization of the Law in Arab States*:* an Investigation into Current Civil, Criminal and Constitutional Law in the Arab World (Austin & Winfield Publishers: Nevada, *1998*);
- Georges Bergougnous, *Presiding Officers of National Parliamentary Assemblies* (Inter-Parliamentary Union: Geneva, 1997);
- Giorgio Agamben, State of Exception. (University of Chicago Press.: Chicago, 2005) ;
- Giuseppe de Vergottini (ed.) *GIUSTIZIA COSTITUZIONALE E SVILUPO DEMOCRATICO NELL PAESI DEL' EUROPA CENTRO – ORIENTALE* (G. Giappicheilli Editore – Torino, 2000);
- Giusepper de Vergottini (ed.), *GIUSTZIA COSTITUZIONALE E SVILUPO DEMOCRATICO NEI PAESI DELL' EUROPA CENTRO – ORIENTALE* (G. Giappichelli Editore: Torino, 2000);
- Gordon Brown (ed.), *The Universal Declaration of Human Rights in the 21st Century. A Living Document in a Changing World* (Open Book Publishers: Cambridge, UK, 2016);
- Grigory Dikov, *Judicial Systems of Central Asia. A Comparative Overview* (Jurisprudence: Moscow, 2015);
- Gustavo Zagrebelsky & Valeria Marceno, *Giustizia costituzionale* (Il Mulino: Bologna, 2012);
- Gustavo Zagrebelsky, *La giustizia costituzionale*. (Il Mulino: Bologna, 1988);
- Gjyljeta Mushkolaj, Visar Morina & Johan Van Laemon, *Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Komentar* (GIZ GmbH, Projekti Reforma Juridike në Kosovë: Prishtinë, 2014);
- Hannah Arendt, *Eichmann in Jerusalem: A Report on the Banality of Evil* (Penguin Classics: London, 2006);
- Hans Kelsen, "La garantie juridictionnelle de la constitution (La justice constitutionnelle)". *Revue du droit public et de la science politique en France et a l' etranger* XXXV (Librarie General de Droit et de Jurisprudence, Paris 1928);
- Hans Kelsen, *General Theory of Law and State*. (Harvard University Press: Cambridge, MA, 1945);
- Hans Kelsen, *Pure Theory of Law* (The Lawbook Exchange, Ltd.: Clark, New Jersey: 2002, 2009);
- Henry Campbell Black, M.S. (ed.), *Black's Law Dictionary. Definitions of the Terms and Phrases of American and English Jurisprudence, Ancient and Modern* (West Publishing Co.: St. Paul, Minnesota, 1968);
- Herman Schwartz, *The Struggle for Constitutional Justice in Post-Communist Europe* (The University of Chicago Press: Chicago, 2000);
- Herman Schwartz, *The Struggle for Constitutional Justice in Post-Communist Europe* (The University of Chicago Press: Chicago, 2000);
- Howard Gillman, *The Constitution Besiged. The Rise and Demise of Lochner Era Police Powers Jurisprudence* (Duke University Press: Durham, North Carolina, 1995);
- Ian Brownlie, *Principles of Public International Law* (Oxford University Press: Oxford, 2003);
- J. Luther - R. Romboli - R. Tarchi (eds.), *Esperienze di giustizia costituzionale*: *Portogallo, Spagna, Belgio, Russia Polonia, Romania, Ungheria*. Tommo II (Giappichelli: Torino, 2000);

- *Jaime Oraa, Human Rights in States of Emergency in International Law* (Oxford Monog (Clarendon Press: Oxford, 1992);
- James Ker-Lindsay, *Kosovo: The Path to Contested Statehood in the Balkans* (I.B.Tauris & Co. Ltd.: London, 2009);
- James McClellan, *Liberty, Order, and Justice: An Introduction to the Constitutional Principles of American Government*. 3rd ed. (Liberty Fund: Indianapolis, 1989);
- James Summers (ed.), *Kosovo: A Precedent? The Declaration of Independence, the Advisory Opinion and Implications for Statehood, Self-Determination and Minority Rights* (Martinus Nijhoff Publishers: The Hague, 2011);
- Jan Zielonka, *Democractic Consolidation in Eastern Europe. Vol. 1. Institutional Engeneering* (Oxford University Press: Oxford, 2001);
- Jasna Dragović-Soso, "*Saviours of the Nation": Serbia's Intellectual Opposition and the Revival of Nationalism* (C. Hurst & Co. Ltd.: London, 2002);
- Jasna Omejec, *Konvencija za zastitu ljudskih prava i temeljnih sloboda u praksi Evropskog suda za ljudska prava: strasbourški acquis* (Novi Inormator: Zagreb, 2013);
- Javier Martínez-Torrón and W. Cole Durham, Jr. (eds.), *Religion and the Secular State: Interim National Reports Issued for the Occasion of the XVIIIth International Congress of Comparative Law* (The International Center for Law and Religion Studies: USA, July 2010);
- Jean – Pierre Massias, *Droit constitutionel des Etats d' Europe de l'Est* (Presses Universitaires de France: Paris, 1999);
- Jean Marc Lacourciere, *Report on the Jurisprudence of the Constitutional Court of Kosovo on Human and Minority Rights* (Kosovo Law Center: Prishtinë, 2011);
- Jean Pierre Massias, *Droit constitutionel des Etats d'Europe de l'Est* (PRESS UNIVERSITAIRES DE FRANCE: Paris, 2008);
- Jerzy Makarczyk *(ed.), Theory of International Law at the Threshold of the 21st Century: Essays in Honour of Krzysztof Skubiszewski* (Kluwer Law International: The Hague, 1996);
- Joanne Banker Hames and Yvonne Ekern, *Constitutional law: Principles and Practice*. Second Edition (CENGAGE Learning, Delmare: USA, 2012);
- John Bell, *French Constitutional Law* (Clarendon Press: Oxford, 2001);
- John Bell, French Constitutional Law (Clarendon Press: Oxford, 1992);
- John Bell, Marie – Luce Paris (eds.), *Rights Based Constitutional Review. Constitutional Courts in Changing Landscape* (Edward Elgar: UK & USA, 2016);
- John Shannon Brady, Beverly Craword and Sarah Elise WSiliarty (eds.), *The Postwar Transformation of Germany: Democracy, Prosperity and Nationhood* (The University of Michigan Press: Michigan, 1999);
- John Williamson (ed.), Latin American Readjustment: How Much Has Happened (Institute for International Economics: Washington, 1989);
- Jonathan Swift, *Gulliver's Travels* (Joe Books Ltd.: Toronto, 2016);
- Jose Maria Beneyto/Ingolf Pernice (eds.), *Europe's Constitutional Challenges in the Light of the recent Case Law of National Constitutional Courts: Lisbon and Beyond* (Nomos, Baden-Baden, 2011);
- Joseph Owona, *Droits constitutionnels et institutions politiques du monde contemporain*. (L'Harmattan: Paris, 2010);
- Josip Metelko, *SUKCESIJA DRZAVA S POSEBNIM OSVRTOM NA RASPAD BIVSE SFRJ* (Pravni fakultet u Zagrebu: Zagreb, 1999;
- Jovan Đorđević, *USTAVNO PRAVO* (Savremena Administracija: Beograd, 1976);
- Jovan Gjorgjeviq, *Sistemi politik. Kontribut shkencës mbi njeriun dhe vetqeverisjen* (Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mesimore i KSAK: Prishtine, 1978);
- Jurgen Basedow, Klaus J. Hopt, Reinhard Zimmermann, and Andreas Stier (eds.), *The Max Planck Encyclopedia of European Private Law* (Oxford University Press: Oxford, 2012);

- Karel Wellens *(ed.), International Law: Theory and Practice; Essays in Honor of Eric Suy*. (Martinus Nijhoff: The Hague, 1998);
- Karen Reid, *A Practicioner's Guide to the European Convention on Human Rights* (Sweet & Macwell Ltd.: London, 2004);
- Karl Smit, "Cuvar ustava". Në Slobodan Samardzic (ed.), *Norma i Odluka. Karl Smit i njegovi kriticari* ("Filip Visnjic": Beograd, 2001);
- Karl Smit, *Tri vrste pravnonaucnog misljenja* (Biblioteka *Parerga*: Beograd, 2003). Titulli në origjinal: Carl Schmitt, *Uber die drei Arten des rechtswissenschaftlichen Denkens* (Hamburg, Hanseatische Verlagsanstalt, 1934);
- Karla W Simon, *Civil Society in China: The Legal Framework from Ancient Times to the"New Reform Era".* (Oxford University Press: Oxford, 2013);
- Kemal Gozler, *Judicial Review of Constitutional Amendments. A Comparative Study* (EKIN PRESS: Bursa, 2008);
- Keneth M. Hollan (ed.), *Judicial Activism in Comparative Perspective* (Palgrave Macmillan: London, 1991);
- Kenneth D. McRae, *Consociational Democracy: Political Accommodation in Segmented Societies*. (McClelland and Stewart Toronto, 1974);
- Kevin Y. L. Tan, *Constitutional Law in Singapore* (Kluwer Law International: The Netherlands, 2011);
- Knut Midgaard & Bjorn Erik Rasch, *Demokracia: kushtet dhe pasojat* (Rozafa: Prishtinë, 2004);
- Kristaq Traja, *Drejtësia Kushtetuese* (Shtëpia Botuese "Luarasi": Tiranë, 2000);
- L. Mezzetti, M. Belletti, E D'Orlando & E. Ferioli, *LA GIUSTIZIA COSTITUZIONALE* (CEDAM: Padova, 2007);
- Lars Vinx (ed.), *The Guardian of the Constitution* (Cambridge University Press: 2015);
- Lars Vinx, The Guardian of the Constitution. Hans Kelsen and Carl Schmitt on the Limits of Constitutional Law (Cambridge University Press: Cambridge: 2015);
- Lars Vinx, *The Guardian of the Constitution. Hans Kelsen and Carl Schmitt on the Limits of Constitutional Law* (Cambridge University Press: Cambridge2015);
- Larry Diamond, Marc F. Plattner (eds.), *Democratization and Authoritarianism in the Arab World* (John Hopkins University Press: Baltimore, 2014);
- *László Sólyom, Constitutional Judiciary in a New Democracy: The Hungarian Constitutional Court, (University of Michigan Press: Michigan, 2000);*
- Latinka Përović, *Kraljevina Srba, Hrvata i Slovenaca (1918–1929)/Kraljevina Jugoslavija (1929–1941): nastanak, trajanje i kraj* (Beograd, 2015);
- Lauri Mälksooand Wolfgant Benedek (eds.), *Russia and the European Court of Human Rights – The Strasbourg Effect* (Cambridge University Press: Cambridge, 2018);
- Laurlel E. Miller (ed.), *Framing the State in Times of Transition. Case Studies in Constitution Making* (United States Institute of Peace Press: Washington D.C., 2010);
- Lawrence Goldstone, *The Activist: John Marshall, Marbury v Madison, and the Myth of Judicial Review* (Walker Publishing Company Inc.: New York, 2008);
- Levent Gonenc, *Prospects for Constitutionalism in Post – Communist Countries* (Martinus Nijhoff Publishers: The Hagues, 2002);
- Lex Corenlia de jurisdictione/Lex Cornelia de edictis, në Bryan A. Garner (ed.), *Black's Law Dictionary,* 9th Ed. (West Publishing, Inc.: St. Paul, Minnesota, 2009);
- Liljana Slavnic, *USTAVNO PRAVO* (Privredna akademija: Novi Sad, 2007);
- Loretta Dell'Aguzzo and Emidio Diodato (es.), *The 'state' of pivot states in south-eastern Mediterranean: Turkey, Egypt, Israel, and Tunisia after the Arab Spring* (Perugia Stranieri University Press: Perugia, 2016);

- Loretta Dell'Aguzzo and Emidio Diodato (es.), *The 'state' of pivot states in south-eastern Mediterranean: Turkey, Egypt, Israel, and Tunisia after the Arab Spring* (Perugia Stranieri University Press: Perugia, 2016);
- Louis Favoreu & Wanda Mastor, *Les cours constituionnelles* 2e edition (Dalloz: Paris, 2016);
- Louis Favoreu et al. (eds.), *Droit constitutionnel* (Dalloz: Paris, 2016);
- Louis Favoreu, Patrick Gaïa, Richard Ghevontian, Jean-Louis Mestre, Otto Pfersmann, André Roux, Guy Scoffoni, *Droit constitutionnel*. 19e édition (Dalloz: Paris 2017);
- Luca Mezzetti (ed.), Sistemi e modelli di giustizia costituzionale (CEDAM: Padova, 2009);
- Lucio Pegoraro, *Giustizia costituzionale comparata. Dai modelli ai sistemi* (G. Giappichelli Editore. Torino, 2015);
- Luís Pereira Coutinho, Massimo La Torre & Steven D. Smith (eds.), *Judicial Activism.An Interdisciplinary Approach to the American and European Experiences* (Springer International Publishing: Switzerland 2015)
- Maartije de Visser, *Constitutional Review in Europe. A Comparative Analysis* (HART Publishing: Oxford and Portland, Oregon 2015);
- Malinverni, Giorgio, *L'expérience de la Commission européenne pour la démocratie par le droit*, in: Flaus, Jean-François, *Vers un droit constitutionnel européen - Quel droit constitutionnel européen? Revue Universelle des Droits de l'Homme* Vol. 7 Nos. 4-6 (1995);
- Marc Jacob. *Precedents and Case-based Reasoning in the European Court of Justice* (Cambridge University Press: Cambridge, 2014);
- Marie-Luce Paris, Europeanization and Constitutionalization: The Challenging Impact of a Double Transformative Process on French Law. *YEARBOOK OF EUROPEAN LAW* No. 29/2010 (Clarendon Press: Oxford, 2010);
- Mari-Žanin Čalić, *Istorija Jugoslavije u XX veku* (Clio: Beograd, 2013);
- Mark Tushnet, Thomas Fleiner and Cheryl Saunders (eds.), *Rutledge Handbook of Constitutional Law* (Rutledge and London, 2013);
- Marko Stanković, *Ustavno sudstvo u savremenim federacijama* (Pravni fakultet Univerziteta u Beogradu: Beograd, 2012);
- Martin Lau, *Role of Islam in the Legal System of Pakistan* (Martinus Nijhoff Leiden, 2005);
- Martin Loughlin & Neil Walker (eds.), *The Paradox of Constitutionalism. Constituent Power and Constitutional Form* (Oxford University Press: Oxford, 2008);
- Math Noortmann and Cedri Ryngaert (eds.), *Non-State Actor Dynamics in International Law: From Law-Takers to Law-Makers* (ASHGATE: England, 2010);
- Maurice Adams, Anne Meuwese, Ernst Hirsch Ballin (eds.), *Constitutionalism and the Rule of law. Bridging Idealism and Realism* (Cambridge University Press: Cambridge, 2017);
- Mauro Cappelleti, Mauro Capelletti & William Cohen, *Comparative Constitutional Law. Cases and Materials* (The Bobbs – Merrill Company, Inc.: USA, 1979);
- Mauro Cappelletti, *The Judicial Process in Comparative Perspective* (Clarendon Press: Oxford, 1989);
- Michael B. Oren, *Six Days of War: June 1967 and the Making of the Modern Middle East* (Presidio Press: New York NY, 2003);
- Michael Bryan, "The modern history of law reporting". *University of Melbourne Collections* Issue 11 (December 2012);
- Michael Verpeaux, La Question Prioritaire de Constitutionnalite (Hachette: Paris, 2013);
- Michel Rosenfeld (ed.), *Constitutionalism, Identity, Difference, and Legitimacy* (Duke University Press: Durham and London, 1994);
- Michel Rosenfeld and Andras Sajo (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law* (Oxford University Press: Oxford, 2012);
- Michel Rosenfeld and Andras Sajo (eds.), The *Oxford Handbook of Comparative Constitution-*

al Law (Oxford University Press: Oxford, 2012);
- Michel Rosenfeld and András Sajó (eds.), The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law (Oxford University Press: Oxford, 2012);
- Miguel-Stearns, Teresa M., "Judicial Power in Latin America: a Short Survey"(2015);
- Mijat Sukovic, *PODGORICKA SKUPSTINA 1918* (DOB: Podgorica, 1999);
- Mijat Sukovic, *USTAVNO PRAVO* (CID: Podgorica 2009);
- Milan Podunavac & Biljana Dordevic (eds.), *Ustavi u vremenu krize: postjugoslovenska perspektiva* (Univerzitet u Beogradu – Fakultet politickih nauka: Beograd, 2014);
- Milan Podunavac & Biljana Dordevic, Ustavi u vremenu krize (Univerzitet u Beogradu, Fakultet politickih nauka: Beogrda, 2014);
- Milovan Buzadzic, *Secesija bivsih jugoslovenskih republika u svetlosti odluka Ustavnog dusa Jugoslavije* (Sluzbeni list SRJ: Beograd, 1994);
- Miodrag Jovicic, *Veliki ustavni sistemi. Elementi za jedno uporedno sutavno pravo* (IRO"Svetozar Markovic: Beograd, 1984);
- Montesquieu, *L' ESPRIT DES LOIS. SUIVI DE LA DEFENCE DE L'ESPRIT DES LOIS. LIVRE XI* (Belin – Leprieur, Libraire – Editeur: Paris, 1845);
- Munkhsaikhan Odonkhuu, *Towards Better Protection of Fundamental Rights in Mongolia: Constitutional Review and Interpretation* (Nagoya University: Japan, 2014);
- Nathan J. Brown, *Constitutions in a Nonconstitutional World* (State University of New York Press: New York: 2002);
- Nathan J. Brown, *Constitutions in a Nonconstitutional World. Arab Basic Law and the Prospects for Accountable Government* (State University of New York Press: New York, 2002);
- Nebojša Popov (ed.), *The Road to War.Trauma and Catharsis* (CEU Press: Budapest, 2000);
- Nerina Boschiero, Tullio Scovazzi, Cesare Pitea & Chiara Ragni (eds.), *International Courts and the Development of International Law Essays in Honour of Tullio Treves* (SPRINGER. The Hague, 2013);
- Nicholas Aroney and John Kincaid (eds.), *Courts in Federal Countries: Federalists or Unitarists?* (University of Toronto Press: Toronto, 2017);
- Nicolas Mansfield, *Creating A Constitutional Court: Lessons From Kosovo*. (The East-West Management Institute (EWMI): New York, Spring, 2013);
- Nigel Foster & Satis Sule, *German Legal System and Laws* (Oxford: Oxford University Press, 2010);
- Nigel Foster & Satish Sule, *German Legal System and Laws*. Fourth Edition (Oxford University Press: Oxford, 2010);
- Noah Feldman, *The Fall and Rise of the Islamic State* (Princeton University Press: Princeton, New Jersy, 2008);
- Noel Malcolm, *Kosovo. A Short History* (New York University Press: New York, 1998);
- Oliver Dörr and Kirsten Schmalenbach (eds.), *Vienna Convention on the Law of Treaties. A Commentary*. Second Edition (Springer - Verlag GmbH: Germany, 2018);
- Olivier Corten, Pierre Klein, Anne Lagerwall, et al., *Droit du pouvoir, pouvoir du droit: Mélanges offerts à Jean Salmon* (Bruylant: Brussels, 2007);
- Omer Hamzić, **"**Ustavno određenje i realni odnosi između organa uprave i samouprave u prvoj deceniji Kraljevine SHS". *Gracanicki glasnik Broj 31 (maj 2011);*
- P. Carrozza, A. Di Giovine & G. F. Ferrari (eds.), *Diritto costituzionale comparato* (GLF Editori Laterza: Roma-Bari, 2009);
- P. M. H. Bell & Mark Gilbert, *The World Since 1945: An International History.* 2nd Edition (Bloomsbury Academic: London etc., 2017);
- Patrizia Pedrezoli, *La Corte costituzionale* (Il Mulino: Bologna, 2008);

- Paul Craig and Gráinne de Búrca (eds.), *EU law. Cases, and Materials*. Fourth Edition (Oxford University Press: Oxford, 2007);
- Paul Kens, *Lochner v. New York: Economic Regulation on Trial* (University Press of Kansas: Lawrence, Kansas 1998);
- Paul O. Carrese, *The Cloaking of Power: Montesquieu, Blackstone, and the Rise of Judicial Activism* (The University of Chicago Press: Chicago, 2003);
- Pavle Nikolic, *USTAVNO PRAVO* (Sluzbeni list SRJ: Beograd, 1993);
- Philip Leach, *Taking a Case to the European Court of Human Rights*. Third Edition (Oxford University Press, Oxford, 2011);
- Philip Leach, *Taking a Case to the European Court of Human Rights*. Third Edition (Oxford University Press: Oxford, 2011);
- Constance Grewe et al. (eds.), *La notion de 'justice constitutionnelle* (Paris: Dalloz, 2005);
- Pieter van Dijk, Fried van Hoof, Arjen Van Rijn, Leo Zwaak (eds.)., *Theory and Practice of the European Convention on Human Rights: Fourth Edition. Fourth Edition* (Intersentia: Antwerpen and Oxford, 2006);
- Pietro Faraguna, *A Living Constitutional Identity: The Contribution of Non-Judicial Actors* (NYU School of Law. New York, NY, 2015);
- Prof.dr. Kurtesh Salihu, *LINDJA, ZHVILLIMI, POZITA DHE ASPEKTET E AUTONOMITETIT TË KRAHINËS SOCIALISTE AUTONOME TË KOSOVËS NË JUGOSLLAVINË SOCIALISTE* (ENTI I TEKSTEVE DHE I MJETEVE MËSIMORE I KTRAHINËS SOCIALISTE AUTONOME TË KOSOVËS: Prishtinë, 1984);
- R. St. J. Macdonald, "Interim Measures in International Law, with Special Reference to the European System for the Protection of Human Rights"*Max-Planck-Institut für ausländisches öffentliches Recht und Völkerrech* (1992);
- Radoslav Prochazka, *Mission Accomplished. On Founding Constitutional Adjudication in Central Europe* (Central European University Press: Budapest / New York, 2002);
- Radoslav Prochazka, *Mission Accomplished. On Founding Constitutional Adjudication in Central Europe* (CEU Press: Budapest / New York, 2002);
- Ralf Rogowski and Thomas Gawron (eds.), *Constitutional Courts in Comparison: The U.S. Supreme Court and the German Federal Constitutional Court* (Berghan Books: New York and Oxford, 2002);
- Ratko Markovic, *USTAVNO PRAVO I POLITICKE INSTITUTCIJE* ("Sluzbeni glasnik": Beograd, 2008);
- Ray Murphy, *UN Peacekeeping in Lebanon, Somalia and Kosovo:Operational and Legal Issues in Practice* (Cambridge University Press:Cambridge, 2007);
- Rein Avovič Müllerson, Malgosia Fitzmaurice, Mads Tønnesson Andenæs (eds.)., *Constitutional Reforms and International Law in Central and Eastern Europe* (The Hague: Martinus Nijhoff Publishers, 1998);
- Rendall Lesaffer, *European Legal History. A cultural and Political Perspective* (Cambridge University Press: Cambridge, 2011);
- Luca Mezzetti (ed.), *SISTEMI E MODELLI DI GUISTIZIA COSTITUZIONALE* (CEDAM: Padova, 2009);
- Robin C.A. White & Clare Ovey, *The European Convention on Human Rights*. Fifth Edition (Oxford University Press: Oxford, 2010);
- Rosalin Dixon and Tom Ginsberg (eds.), *Comparative Constitutional Law in Asia* (Edward Elgar Publishing Limited: United Kingdom, 2014);
- S. E. Finer, *The History of Government. Vol. I.: Ancient Monarchies and Empires* (Oxford University Press: Oxford, 1999);
- Simon Butt, *The Constitutional Court and Democracy in Indonezia* (Brill Nijhoff: Leiden and

Boston, 2015);
- Sir Basil Markesinis & Jorg Fedtke, *Judicial recourse to Foreign Law. A New Source or Inspiration?* (Routledge: London and New York, 2006);
- Slobodan Jovanovic, *Ustavno pravo Kraljevine srba, hrvata i slovenaca* (Sluzbeni list SRJ: Beograd, 1995);
- Slobodan Samardzic (ed), *Norma i Olduka: Karl Smit i Njegovi Kriticari* ("Filip Visnjic": Beograd, 2001);
- Beograd, 2001). Titulli i origjinalit: Carl Schmitt, "Der Huter der Verfasung". A*rchiv des offentlichen rechts*. Neue Folge 16 Band J.C.B. Mohr (Paul Siebeck), Tubingen 1929;
- Slobodan Samardzic (ed.), *Norma i odluka. Karl Smit i njegovi kriticari* ("Filip Visnjic": Beograd, 2001);
- Srdja Pavlovic, *Balkan Anschluss:* The Annexation of Montenegro and the Creation of the Common South Slavic State (Purdue University Press: West Lafayette, Indiana, 2008);
- Sujit Choudhry (ed.), *Constitutional Design for Divided Societies: Integration or Accommodation*? (Oxford University Press: Oxford, 2008);
- Susan Lape, *Reproducing Athens. Menander's Comedy, Democratic Culture, and the Helenistic City* (Princeton University Press: Princeton, 2004);
- Suzie Navot, *The Constitutional Law of Israe*l (Kluwer Law International: The Netherlands, 2007);
- Svetomir Skaric, *USTAVNO PRAVO* (KULTURA: Skopje, 2015);
- Tom Campbell, K.D. Ewing, and Adams Tomkins, *The Legal Protection of Human Rights. Skeptical Essays* (Oxford University Press: Oxford, 2011);
- Tom Ginsburg and Rosalind Dixon, *Comparative Constitutional Law* (Edward Elgar: USA, 2011);
- Tom Ginsburg, *Judicial Review in New Democracies. Constitutional Courts in Asian States* (Cambridge University Press: Cambridge, 2003);
- Turkuler Isiksel, *Europe's Functional Constitution. A Theory of Constitutionalism Beyond the State* (Oxford University Press: Oxford, 2016);
- The Commonwealth, *The Appointment, Tenure and Removal of Judges under Commonwealth Principles. A Compendium and Analysis of Best Practice* (The British Institute of International and Comparative Law: London, 2015);
- *The Digest of Justinian*, Vol. I, translated by Charles Henry Monroe, M.A. (Cambridge at the University Press: Cambridge 1904);
- Thomas Barkhuysen, Michiel Leonard van Emmerik and Piet Hein van Kempen (eds,), *The Execution of Strasbourg and Geneva Human Rights Decisions in the National Legal Order* (Martinus Nijhoff Publishers: The Hague/Boston /London, 1999);
- Thomas Horsley, *The Court of Justice of the European Union as an Institutional Actor: Judicial Lawmaking and Its Limits* (Cambridge University Press: Cambridge, 2018);
- United Kingdom, 2018);
- *Ustav SRFJ. Ustavi socialistickih republika i pokrajina* ("Slobodna Dalmacija": Beograd, 1974);
- Vello Pettai and Jan Zielonka (eds.) *The Road to the European Union Vol. 2: Estonia, Latvia and Lithuania* (Manchester University Press: Manchester/New York, 2003);
- Veronica Magrini, *L'astensione e la ricusazione quali strumenti per la realizzazione dell'imparzialità del giudice costituzionale*. UNIVERSITÀ DI PISA DIPARTIMENTO DI GIURISPRUDENZA. Dottorato di ricerca in Scienze giuridiche-XXVI ciclo. CURRICULUM IN GIUSTIZIA COSTITUZIONALE E DIRITTI FONDAMENTALI, Coordinatore: Ch.mo Prof. Roberto Romboli (Giugno 2016);
- Vesela Mukoska – Cingo, *Konstitucionalizam* (Univerzitet Sv."Kiril i Metodij"– Pravni

Fakultet"Justinijan Prvi": Skopje 2006);

- Vesela Mukoska-Čingo, *Ustavno sudstvo: teorija i praktika* (Samozal.: Skopje, 2002);
- Vicki C. Jackson and Mark Tushnet, *Comparative Constitutional Law* (Foundation Press: New York NY, 2006);
- Vicki C. Jackson, *Constitutional Engagement in a Transnational Era* (Oxford University Press: Oxford, 2010);
- Vincenzo Cuoco, *Historical Essay on the Neapolitan Revolution of 1799* (University of Toronto Press: Toronto, 2014);
- Visar Morina, *Gjyqësia Kushtetuese* (Instituti Për Studime Kushtetuese dhe Parlamentare, 2017);
- Vladimir Đuro Degan, *Međunarodno pravo* (Skolska Knjiga: Zagreb, 2011);
- Vladimir Ibler, *Rječnik Medjunarodnog Javnog Parava* (Informator: Zagreb, 1972);
- William A. Schabas, *The European Convention on Human Rights.A Commentary* (Oxford University Press: Oxford, 2015);
- William E. Nelson, *Marbury v. Madison. The Origins and Legacy of Judicial Review* (University Press of Kansas: Kansas, 2000);
- William Hooker, *Carl Schmitt's International Thought. Oder and Orientation* (Cambridge University Press: Cambridge, 2009);
- William Shakespeare, *The Merchant of Venice* (Tale University Press: New Haven and London, 2006), Act IV, Scene I;
- Wojciech Sadurski (ed), *Constitutional Justice, East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective* (Kluwer Law International: The Hague, 2002);
- Wojciech Sadurski, Adam Czarnota, Martin Krygier (eds.), *Spreading Democracy and the Rule of law? The Impact of EU Enlargement for the Rule of law, Democracy and Constitutionalism in Post-Communist Legal Orders* (SPRINGER: Dordrecht, the Netherlands, 2006);
- Wojciech Sadurski, *Rights Before Courts. A Study of Constitutional Courts in Postcommunist States of Central and Eastern Europe* (Springer: Dordrecht, The Netherlands, 2008);
- Wolfgang Benedek, Philip Czech, Lisa Heschl, Karin Lukas and Manfred Nowak (eds.), *European Yearbook on Human Rights* (Intersentia: Cambridge, Antwerp, Chicago, Vienna, 2018);
- Xhezair Zaganjori, *Jurisprudencë dhe praktikë ndërkombëtare* (MORAVA: Tiranë, 2011);
- Yaniv Roznai, *Unconstitutional Constitutional Amendments: A Study of the Nature and Limits of Constitutional Amendment Powers*. The London School of Economics and Political Science. A thesis submitted to the Department of Law of the London School of Economics for the degree of Doctor of Philosophy. London, February 2014;
- Zoran Sulejmanov & Dejan Sulejmanov, *USTAVNO SUDSTVO* (Fleksograf: Kumanovo & Skopje, 2013);
- Zhenis Kembayev, *Constitutional Law of the Republic of Kazakhstan* (Academpress: Ukraine, 2014).

B. ARTIKUJ:

- A. A. S. Zuckerman, "Quality and Economy in Civil Procedure: The Case for Commuting Correct Judgments for Timely Judgments *Oxford Journal of Legal Studies* Volume 14 Issue 3 (Autumn 1994);
- A. Chun'kov, "Supervision of the Execution of Decisions of the Constitutional Court of the Russian Federation."*Statutes & Decisions* Vol. 41 No. 2 (March – April 2005);
- Aborisade Olasunkanmi, "Appraisingg Constitutionalism and Good Governance in Africa". *International Journal of Interdisciplinary Research Methods* Vol.2 No. 2 (June 2015);
- Aborisade Olasunkanmi, "Constitutionalism and the Challenges of Development in Africa". *International Journal of Politics and Good Governance* Vol. 5 No. 5. 4 Quarter IV (2014);
- Adem Beha, "Consociational Democracy and Political Engineering in Postwar Kosovo". *Nationalities Papers* Vol. Vol. 47 Issue 4 (July 2019);
- Adem Kassie Abebe and Charles Manga Fombad, "The Advisory Jurisdiction of Constitutional Courts in Sub-Sahara". *George Washington International Law Review* Vol 46 No. 1 (2013);
- Adolf Berger, *Encyclopedic Dictionary of Roman Law*, Volume 43, Part 2 (American Philosophical Society: Philadelphia, 1951);
- Advisory Opinions and the Influence of the Supreme Court over American Policymaking. *Harvard Law Review* Vol. 124 No. 8 (June 2011);
- Aeyal M. Gross, "The Politics of Rights in Israel Constitutional Law"Israel Studies Vol. 3 Number 2 (Fall 1998) fq. 80-118; Daphne Barak-Erez, "BROADENING THE SCOPE OF JUDICIAL REVIEW IN ISRAEL: BETWEEN ACTIVISM AND RESTRAINT". *Indian Journal of Constitutional Law* Vol. 8 Number 3 (2009);
- Aharon Barak"A Judge on Judging: The Role of a Supreme Court in a Democracy", *Harvard Law Review* Vol. 116 No. 16 (2002-2003);
- Aharon Barak, "A Constitutional Revolution: Israel's Basic Laws". *Faculty Scholarship Series.* Paper 3697 (1993);
- Aharon Barak, "The Supreme Court and the Problem of Terrorism". Në Supreme Court of Israel and Ministry of Foreign Affairs (eds.), *Judgements of the Israel Supreme Court: Fighting Terrorism within the Law*. Vol. 1 (Jeruslaem, 2009);
- Ahron Barak, "Unconstitutional Constitutional Amendments". *Israel Law Review* Vol. 44 No. 3 (2012);
- Alan Roger, "Behind the Scenes of Roman Law". *Oxford Journal of Legal Studies* Vol. 3, No. 3 (Winter, 1983);
- Alan Watson, "The Development of the Praetor's Edict". *The Journal of Roman Studies* Vol. 60 Issue 1 (November 1970);
- Alastair Mowbray, "A New Strasbourg Approach to the Legal Consequences of Interim Measures". *Human Rights Law Review* Vol. 5 No. 2 (2005;
- Alastair Mowbray, "A New Strasbourg Approach to the Legal Consequences of Interim Measures *Human Rights Law Review* Volume 5 Issue 2 (2005);
- Alec Stone Sweet, "Constitutional Courts and Parliamentary Democracy" *West European Politics* Vol.25, No.1 (January 2002);
- Alessio Rauti, "Riflessioni in tema di imparzialità dei giudici costituzionali". *Giurisprudenza costituzionale*, Vol. 54 No. 5 (2009);
- Alex Schank, "Constitutional Shari'a: Authoritarian Experiments with Islamic Judicial Review in Egypt, Iran, and Saudi Arabia". *The Georgetown Law Journal* Vol. 102 Issue 2 (2014);
- Alex Schank, "Constitutional Shari'a: Authoritarian Experiments with Islamic Judicial Review in Egypt, Iran, and Saudi Arabia". *The Georgetown Law Journal* Vol. 102 Issue 2 (2014);
- Alex Schwartz and Melanie Janelle Murchison"Judicial Impartiality and Independence in Divided Societies: An Empirical Analysis of the Constitutional Court of Bosnia – Herzegov-

ina”*Law & Society Review*, Vol. 50, No. 4 (2016);

- Alexander H. E. Morawa, “Kafka, Kelsen and Supremacy: How European Courts Could Interact with a View to Fostering Constitutionalism”. Në Kyriaki Topidi and Alexander H. E. Morawa (eds.), *Constitutional Evolution in Central and Eastern Europe;*
- Alfred P. Rubin, “The International Legal Effects of Unilateral Declarations.”*American Journal International Law* Vol. 71 No. 1 (January 1977);
- Alfred Stepan, “Tunisia’s Transition and the ”Twin Tolerations”. Në Larry Diamond, Marc F. Plattner (eds.), *Democratization and Authoritarianism in the Arab World* (John Hopkins University Press: Baltimore, 2014);
- Alfredo Mordechai Rabello, “Non Liquet: From Modern Law to Roman Law”. *Annual Survey of International & Comparative Law* Volume 10 Issue 1 (2004).
- Ali Acar, “TENSION IN THE TURKISH CONSTITUTIONAL DEMOCRACY: LEGAL THEORY, CONSTITUTIONAL REVIEW AND DEMOCRACY”. *Ankara Law Review* Vol. 6 No. 2 (Winter 2009);
- Allan Brewer-Carías, “La jurisdicción constitucional en América Latina” [Latin American constitutional jurisdiction]. Në Domingo García Belaúnde & D. Fernández Salgado (eds.), *La jurisdicción constitucional en Iberoamérica* (Dykinson: Madrid, 1977);
- Amina El Messaoui, “La giustizia costituzionale in Marocco”. Në Luca Mezzetti (ed.), *SISTEMI E MODELLI DI GIUSTIZIA COSTITUZIONALE. TOMO II* (CEDAM: Padova, 2011);
- Amon Mukhamedjanov, “The Role and Place of the Constitutional Court of the Republic of Uzbekistan in Protection of the Human Rights and Freedoms”. *Asia Law Quarterly* Vol. 1 No.1 (2009);
- Amon Mukhamedjanov, “The Role and Place of the Constitutional Court of the Republic of Uzbekistan in Protection of the Human Rights and Freedoms”;
- Amos Shapira, “Judicial Review Without a Constitution: The Israeli Paradox”. *Temple Law Quarterly*, Vol. 56 Issue 2 (1983);
- Amy J. Weisman, “Separation of Powers in Post-Communist Government: A Constitutional Case Study of the Russian Federation. ”*American University International Law Review* Vol. 10 Issue 4 (1995);
- Anahit Manasyan, “Execution of the Constitutional Court Decisions as a Guarantee for Strengthening the Constitutionalism (Example of the Republic of Armenia)”. *Juridiskā zinātne / Law* (Journal of the University of Latvia) No. 8 (2015);
- Andea Lollini, “La Corte costituzionale sudafricana”. Në Luca Mezzeti, *Sistemi e Modeli di Giustizia Costituzionale*. Tomo I (CEDAM: Padova, 2009);
- András Jakab - Johanna Fröhlich, “The Constitutional Court of Hungary”. Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* (Cambridge University Press: Cambridge, 2017);
- András Jakab, “Two Opposing Paradigms of Continental European Constitutional Thinking: Austria and Germany” *The International and Comparative Law Quarterly* Vol. 58 No. 4 (October 2009);
- András Jakab, Johanna Fröhlich, “The Constitutional Court of Hungary”. Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning;*
- Andrea Lorenzo Capussela, “A Critique of Kosovo’s Internationalized Constitutional Court”. *European Diversity and Autonomy Papers*. EDAP 02/2014;
- Andreas Rahmatian, “Friedrich Carl v. Savigny’s ‘Beruf’ and ‘Volksgeistlehre’.”*Journal of Legal History* Vol. 28 No. 1 (2007);
- Andrew Harding and Peter Leyland, “The Constitutional Courts of Thailand and Indonesia: Two case Studies from South East Asia”. Në Andrew Harding and Peter Leyland (eds.), *Constitutional Courts. A Comparative Study*;

- Angelo Dube and Musavengana Machaya, "The Doctrine of *Res Judicata* Revisited: Molaudzi v. the State" *Strategic Review for South Africa* Vol. 39 No. 2 (November 2017);
- Anna Fruhstorfer and Michael Hein, "From Post-socialist Transition to the Reform of Political Systems? Comparing Constitutional Politics in Central and Eastern Europe". Në Anna Fruhstorfer and Michael Hein (eds.), Constitutional Politics in Central and Eastern Europe. From Post-Socialist Transition to the Reform of Political Systems (Springer: Wiesbaden, 2016);
- Anna Silvia Bruno & Massimo Cavino (eds.), *Esperienze di diritto vivente. La giurisprudenza negli ordinamenti di diritto legislativo. Vol. 2. Italia, Messico, Peru', Cile, Bolivia, Svezia, Norvegia, Finlandia, Danimarca, Russia, Polonia, Romania, Ungheria, Croazia* (Giuffrè Edittore: Milano, 2011);
- Anne Peters, "Supremacy Lost: International Law Meets Domestic Constitutional Law". *Vienna Journal on International Constitutional Law*. Vol 3 Issue 3 (September 2009);
- Anver M. Emon, "The Limits of Constitutionalism in the Muslim World: History and Identity in Islamic Law". Në Sujit Choudhry (ed.), *Constitutional Design for Divided Societies: Integration or Accommodation*? (Oxford University Press: Oxford, 2008);
- Arend Lijphart, "Consociation and Federation: Conceptual and Empirical Links". *Canadian Journal of Political Science*. Vol. 12 Issue 3 (September, 1979);
- Arendt Lijphart, "Consociational Democracy". *World Politics*. Vol. 21 Issue (January, 1969);
- Ariel L. Bendor, "Are There Any Limits to Justiciability? The Jurisprudential and Constitutional Controversy in Light of the Israeli and American Experience". *Indiana International & Comparative law Review* Vol. 7 No. 2 (1997);
- Arnaud Le Pillouer, "Pouvoir constituant originaire et pouvoir constituant dérivé: à propos de l'émergence d'une distinction conceptuelle"*Revue d'histoire des facultés de droit et de la science juridique* no. 25-6 (2005-6);
- Arthur Dyevre, "The French Constitutional Council". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* (Cambridge University Press: Cambridge, 2017);
- Arthur W. Machen, Jr., "Corporate Personality" *Harvard Law Review* Vol. 24, No. 4 (Feb., 1911);
- Artour Rostorotski, "Book Review –David A. Strauss' *The Living Constitution* (2010)". *German law Journal* Vol. 12 No. 07 (2011);
- Askar Jalalian & Parisa Anvari, "A comparative study of judicial control in Iran, U.S.A and Canada." *International Letters of Social and Humanistic Sciences Online: 2014-12-15*;
- Atupare Atudiwe P., Courts, Interpretation and Constitutions in Africa: A Focused Inquiry into Comparative Constitutional Interpretation in Ghana and Nigeria, *Review of Ghana Law* Vol. 22 (2006-2010);
- Augusto Zimmermann, "The 'Darwin' of German legal theory—Carl von Savigny and the German School of Historical Law" *Journal of Creation* Vol. 27 No. 2 (2013);
- Aumann, F. Robert, "The Supreme Court and the Advisory Opinion". *Law Journal*, Vol. 4, No. 1 (1937);
- Axel Tschentscher and Caroline Lehner, "The Latin American Model of Constitutional Jurisdiction: Amparo and Judicial Review (July 19, 2013);
- Babacar Kante"Models of Constitutional Jurisdiction in Francophone Africa". Në Tom Ginsburg, "Constitutional Courts in East Asia: Understanding Variation."Në Andrew Harding and Peter Leyland (eds.), *Constitutional Courts. A Comparative Study* (Wildy, Simmonds & Hill Publishin: London, 2009);
- Babacar Kante, "Models of Constitutional Jurisdiction in Francophone West Africa". *Journal of Comparative Law* Volume 3 Issue 2 (2008);
- Bandar Eid Al Harbi, "Constitutionalism, Constitutionalisation and Legitimacy: Reforming *Al-Shura* Council Law in Saudi Arabia". *A Thesis Submitted for the Degree of Doctor of Phi-*

losophy in Law (Law School Brunel University London: November 2014);
- Barry Cushman, "Teaching the Lochner Era". *Saint Louis University law Journal* Vol. 62 No. 3 (Spring 2018);
- Barry Friedman, "The History of the Counter majoritarian Difficulty, Part Four. Law's Politics". *University of Pennsylvania Law Review* Vol. 148 No. 4 (April, 2000);
- Benjamin Kaplan, Arthur T. von Mehren and Rudolf Schaefer, "Phases of German Civil Procedure I" *Harvard Law Review* Vol. 71 No. 7 (May, 1958);
- Benjamin Suter, "Appointment, Discipline and Removal of Judges: A Comparison of the Swiss and New Zealand Judiciaries" *Victoria University of Wellington Law Review* Vol. 46 No. 2 (2015);
- Bertrand Mathieu, "Le Conseil constitutionnel" législateur positif"ou la question des interventions du juge constitutionnel français dans l'exercice de la fonction legislative" Revue internationale de droit comparé Vol. 62 No. 2 (2010);
- Björn Arp, "The ICJ Advisory Opinion on the Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in Respect of Kosovo and the International Protection of Minorities". *German Law Journal,* Vol. 11, No. 08 (2010);
- Blanca Rodrigues Ruis, "Recognizing the rights of unmarried cohabitants in Spain: Why not treat them like married couples? *International Journal of Constitutional Law* Vol. 2 No. 4 (2004);
- Blaže Krcinski, "Neki problemi ustavnosudske kontrole u Makedoniji."*HRVATSKA I KOMPARATIVNA JAVNA UPRAVA*, br. 2 god. 11 (2011);
- Bojan Spaić, "The Authority of Precedents in Civil Law Systems". *Studia Iuridica Lublinensia* Vol. XXVII No. 1 (2018);
- Boris Andreev, "Russia and *Non Bis In Idem* Principle in International and Russian Law" *Revue internationale de droit penal* 2002/3 Vol. 73 (2002/3);
- Bosa Nenadic, "UVODNE NAPOMENE". Në Bosa Nenadic (ed.), *USTAVNI SUD REPUBLIKE SRBIJE 1963-2008* (Sluzbeni glasnik: Beogrda, 2009);
- Boštjan M. Zupančič, "Constitutional Law and the Jurisprudence of the European Court of Human Rights: An Attempt at a Synthesis*". Revus. Journal for Constitutional Theory and Philosophy of Law / Revija za ustavno teorijo in filozofijo prava*. 1 (2003);
- Brain Porter, "The 1989 Polish Round Table Revisited: Making History." *The Journal of the International Institute* Volume 6, Issue 3 (Summer 1999);
- Brian Galligan, "Judicial Activism in Australia". Në Keneth M. Hollan (ed.), *Judicial Activism in Comparative Perspective* (Palgrave Macmillan: London, 1991);
- **Brittney Kern**, "Giving New Meaning to"Justice for All": Crafting an Exception to Absolute Judicial Immunity" *Michigan State Law Review* Vol. 2014 Issue 1 (2014);
- Cai Dingjian, "Constitutional Supervision and Interpretation in the People's Republic of China" *Journal of Chinese Law* Vol. 9 No. 2 (Fall 1995);
- Carl Baar, "Judicial Activism in Canada". Në Keneth M. Hollan (ed.), *Judicial Activism in Comparative Perspective* (Palgrave Macmillan: London, 1991);
- Carlos Martínez de Aguirre, "Same-sex marriage in Spanish law" *PRAWO W DZIAŁANIU SPRAWY CYWILNE* Tom 25 SPIS TREŚCI (2016);
- Carna Pistan, "La giustizia costituzionale nell' Europa centro-orientale: le esperienze di Croazia, Slovenia, Polonia, Ungheria." Në Luca Mezzeti (ed.) *SISTEMI E MODELI DI GIUSTIZIA COSTITUZIONLAE*;
- Catherine Dupre and Jiunnrong Yeh, "Constitutions and legitimacy over time". Në Mark Tushnet, Thomas Fleiner and Cheryl Saunders (eds.), *Rutledge Handbook of Constitutional Law* (Rutledge and London, 2013);
- Charles Aikin, "Stare Decisis, Precedent and the Constitution". *The Western Political Quarter-*

ly Vol. 9, No. 1 (Mar., 1956);
- Charles J. Reid, Jr., "Judicial Precedent in the Late Eighteenth and Early Nineteenth Centuries: A Commentary on Chancellor Kent's Commentaries" *Ave Maria Law Review* Vol. 5 No. 1 (2007);
- Charles Soule, "Stare Decisis in Continental Europe". *Green Bag* Vol. 19 (1907);
- Cherly Saunders and Adrienne Stone, "The High Court of Australia". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* (Cambridge University Press: Cambridge, 2017);
- Chibli Mallat, "On the Specificity of Middle Eastern Constitutionalism" *Case Western Reserve Journal of International Law* Vol. 38 Issue 1 (2006);
- Christa Rautenbach and Lorens Du Plessis, "The Constitutional Court of South Africa". Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning;*
- Christian Boulanger, "Europeanization Through Judicial Activism? The Hungarian Constitutional Court's Legitimacy and the 'Return to Europe'." Në Wojciech Sadurski, Adam Czarnota, Martin Krygier (eds.), *Spreading Democracy and the Rule of law? The Impact of EU Enlargement for the Rule of law, Democracy and Constitutionalism in Post-Communist Legal Orders* (SPRINGER: Dordrecht, the Netherlands, 2006);
- Christian Djeffal, "Commentaries on the Law of Treaties: A Review Essay Reflecting on the Genre of Commentaries". *The European Journal of International Law* Vol. 24 no. 4 (2013);
- Christian J. Tams, "Interim Orders by the European Court of Human Rights – Comments on Mamatkulov and Abdurasulovic v. Turkey"*Zeitschrift für ausländisches öffentliches Recht und Völkerrecht* 63 (2003);
- Christian Rautenbach and Lourens Du Plessis, "The Constitutional Court of South Africa". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* (Cambridge University Press: Cambridge, 2017);
- Christina Morus, "The SANU Memorandum: Intellectual Authority and the Constitution of an Exclusive Serbian 'People'" *Communication and Critical/Cultural Studies* Vol. 4 Issue 2 (2007);
- Christine van den Wyngaert and Guy Stessens, "The International *Non Bis In Idem* Principle: Resolving Some of the Unanswered Questions" *The International and Comparative Law Quarterly* Vol. 48, No. 4 (Oct., 1999);
- Christoph Grabenwarter, "Separation of Powers and the Independence of Constitutional Courts and Equivalent Bodies". *Keynote Speech, 16 January 2011, 2nd Congress of the World Conference on Constitutional Justice* (Rio de Janeiro, 2011);
- Christopher J. Walker, "Toward Democratic Consolidation? The Argentine Supreme Court, Judicial Independence, and the Rule of Law". *Florida Journal of International Law* Vol. 18 No. 3, (2010);
- Christos L. Rozakis, "The European Judge as Comparatist". Në Sir Basil Markesinis & Jorg Fedtke, *Judicial recourse to Foreign Law. A New Source or Inspiration?* (Routledge: London and New York, 2006);
- Clark B. Lombardi & Nathan J. Brown, "Do Constitutions Requiring Adherence to Shari'a Threaten Human Rights? How Egypt's Constitutional Court Reconciles Islamic Law with the Liberal Rule of Law". *American University International Law Review* Vol. 21 Issue 3 (2006);
- Colin Warbrick, "Kosovo: The Declaration of Independence" *International and Comparative Law Quarterly*. Volume 57 Issue 03 (July 2008);
- Collins Lawrence, "Provisional and protective measures in international litigation" *Collected Courses of the Hague Academy of International Law* Vol. 234 No. 3 (1992);
- Conrad Lachmayer, "The Austrian Constitutional Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning;*
- Conrado Hubner Mendes, "The Supreme Federal Tribunal of Brasil". Në András Jakab, Arthur

Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* (Cambridge University Press: Cambridge, 2017);

- Corri Zoli, Emily Schneider, "How Islamic Is Pakistan's Constitution". *Foreign Policy* 15 May 2014;
- Craig Eggett, "The Role of Principles and General Principles in the 'Constitutional Processes' of International Law" *Netherlands International Law Review* Vol. 66 Issue (2019);
- Csaba Gergely Tamás, "The Birth of the Parliamentary Democracy in Japan: An Historical Approach."Zeitschrift für Japanisches Recht / Journal of Japanese Law Vol. 17 (Spring) No. 33;
- D. K. Lipstein, "The Doctrine of Precedent in Continental Law with Special Reference to French and German Law", *Journal of Comparative Legislation and International Law*, Vol. 28, No. 3/4 (1946);
- Damian Chalmers, "Judicial authority and the constitutional treaty". *International Journal of Constitutional Law* Volume 3 Issue 2-3 (2005);
- Dane Ally, "A Comparative Analysis of the Constitutional Frameworks for the Removal of Judges in the Jurisdictions of Kenya and South Africa". *Athens Journal of Law* Vol. 2 No. 3 (July 2016);
- Daniel Thym, "From Ultra Vires Control to Constitutional – Identity – Review: The Lisbon Judgement and German Constitutional Court." Në Jose Maria Beneyto/Ingolf Pernice (eds.), *Europe's Constitutional Challenges in the Light of the recent Case Law of National Constitutional Courts: Lisbon and Beyond* (Nomos, Baden-Baden, 2011);
- Daphne Barak-Erez, "Judicial Review of Politics: The Israeli Case" *Journal of Law and Society* Vol. 29, No. 4 (Dec., 2002);
- Daphne Barak-Erez, "BROADENING THE SCOPE OF JUDICIAL REVIEW IN ISRAEL: BETWEEN ACTIVISM AND RESTRAINT". *Indian Journal of Constitutional Law* Vol. 8 No. 3 (2009);
- David KC Huan, "The Court and the Legislation of Same Sex Marriage: A Critical Analysis of the Judicial Yuan Interpretation No. 748 [2017]. *University of Pennsylvania Asian law Review* Vol. 14 No. 1(2019);
- David Kretzmer, "Judicial Review of Knesset Decisions". *Tel Aviv University Studies in Law* Vol. 8 (1988);
- David Sloss"Non-Self-Executing Treaties: Exposing a Constitutional Fallacy". *U.C. Davis Law Review*. Vol. 36 No. 1 (November 2002);
- Dieter Giesen, "Sex Discrimination in Germany (W)". *The Modern Law Review* Vol. 41 No. 5 (Sep., 1978);
- Domentico Amirante, "Giustizia costituzionale e affermazione dellla democrazia nell'Unione indiana". Në Luca Mezzetti (ed.), *Sistemi e modelli di giustizia costituzionale* (CEDAM: Padova, 2009);
- Donald P. Kommers, "German Constitutionalism: A Prolegomenon". *Emory Law Journal,* Vol. 40, Issue 1 (Summer, 1991);
- Donald P. Kommers, *The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany.* Second Edition. (Duke University Press: Durham and London, 1997);
- Donald P. Kommers, "The Federal Constitutional Court: Guardian of German Democracy" *The Annals of the American Academy of Political and Social Science.* Law, Society, and Democracy: Comparative Perspectives. Vol. 603 (January 2006);
- Dr. sc. Jasna Omejec, "Kontrola ustavnosti ustavnih normi (ustavnih amandmanai ustavnih zakona)". (Control of Constitutionality of Constitutional Norms (Constitutional Amendmends and Constitutional Laws). *Godisnjak Akademije pravnih znanosti Hrvatske*, Vol. 1 No. 1 (Prosinac 2010);
- Dren Doli & Fisnik Korenica, "Kosovar Constitutional Court's Jurisdiction: Searching for

Strengths and Weaknesses." *German Law Journal* Vol. 11 No. 08 (2010);

- Dren Doli / Fisnik Korenica, "What about Kosovo's Constitution: Is there anything special? Discussing the grundnorm, the sovereignty, and the consociational model of democracy." *Vienna Journal on International Constitutional Law* Vol. 5 No.1 (2011);
- Dren Doli dhe Fisnik Korenica, "The Consociational System of Democracy in Kosovo: Questioning Ethnic Minorities' Special Status in Kosovo's Constitutional Regime" *International Journal of Public Administration* Vol. 36 No. 9 (2013);
- Dren Doli, Fisnik Korenica & Albana Rexha, *Promising Early Years: The Transformative Role of the Constitutional Court of Kosovo* (Analitika: Center for Social Research, Sarajevo, 2015);
- E. Burke Inlow, "The Supreme Court of Iran". *Osgoode Hall Law Journal* Volume 8 No. 3 (December 1970);
- E. G. H. Joffé." The Moroccan Nationalist Movement: Istiqlal, the Sultan, and the Country" *The Journal of African History* Vol. 26 No. 4, World War II and Africa (1985);
- Eduardo Ferrer Mac-Gregor, "La Corte suprema di giustizia del Messico quale tribunale costituzionale."Në Luca Mezzetti (ed.), *SISTEMI E MODELLI DI GIUSTIZIA COSTITUZIONALE* (CEDAM: Padova, 2009);
- Edward Mead Early, "The New Constitution of Turkey". *Political Science Review* Volume 40 Issue 1 (March 1925);
- Eivind Smith, "Constitutional Courts As 'Positive Legislators'". *Paper presented at the: International Academy of Comparative Law. XVIII International Congress of Comparative Law*. (Washington, D.C., July 25-31, 2010);
- Eivind Smith, "Courts of people, not of norms? Law and fact in constitutional Review as performed by courts of general or administrative jurisdiction". European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *International Conference. Law and Fact in Constitutional Jurisprudence*, 30 June - 1 July 2005, Vilnius, Lithuania. *CDL-JU(2005)022;*
- Elena Cirkovic, "An Analysis of the ICJ Advisory Opinion on Kosovo's Unilateral Declaration of Independence". *German Law Journal,* Vol. 11, No. 08 (2010);
- Elizabeth Wiskemann, "The Saar Moves toward Germany" *Foreign Affairs* Vol. 34, No. 2 (January, 1956);
- Elke Luise Barnstedt, "Differences Between Constitutional Complaints That Challenge Court Rulings And Those That Challenge Statutes". Në European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), Fourth Conference of Secretaries General of Constitutional Courts and Courts of Equivalent Jurisdiction, Ankara, Turkey, 1-2 October 2009. Venice Commission. *CDL-JU(2009);*
- Elvia Arcelia Quintana Adriano, "The Natural Person, Legal Entity or Juridical Person and Juridical Personality". *Penn State Journal of Law & International Affairs* Vol. 4 No. 1 (2015);
- Emanuele Cimiotta, The Specialist Chambers and the Specialist Prosecutor's Office in Kosovo. The'Regionalization'of International Criminal Justice in Context". *Journal of International Criminal Justice* Vol. 14 Issue 1 (March, 2016);
- Emily Hay, "International (ized) Constitutions and Peacebuilding". *Leiden Journal of International Law* Vol. 27 No. 01 (2014);
- Engin Yildirim, "Individual application to the Turkish Constitutional Court as a case of constitutional transfer". *Global Constitutionalism* Vol. 5 Issue 2 (July 2016);
- Enrique Guillen Lopez, "Judicial Review in Spain: The Constitutional Court"*Loyola of Los Angeles law Review* Vol. 41 Issue 2/3 (2008);
- Enver Hasani, "Constitutional Protection of the Head of State: The Case of Kosovo". Në *Vienna Journal on International Constitutional Law – ICL Journal,* Volume 7, No. 2 (February 2013);
- Enver Hasani, "Self-Determination under the Terms of the 2002 Union Agreement between Serbia and Montenegro: Tracing the Origins of Kosovo Self-Determination", botuar në *Chica-*

go Kent Law Review, Vëllimi 80 Nr. 1 (2005);
- Enver Hasani, "Specifikat e trashëgimit të ish Jugosllavisë dhe pozita e Kosovës në të", botuar në E *DREJTA/LAW* nr. 1/2012;
- Enver Hasani, "The case of the Serb Association before the Constitutional Court of Kosovo". Në Andrzej Szmyt and Boguslaw Banaszak (eds.), *Transformation of Law Systems in Central, Eastern and Southeastern Europe in 1989-2015* (Gdansk University Press: Gdansk, 2016);
- Enver Hasani, "The Evolution of Succession Process in Former Yugoslavia", botuar në *Tomas Jefferson Law Review* Vol. 29 No. 1 2006 (SHBA);
- Enver Hasani, "The Role of the Constitutional Court in the Development of the Rule of Law in Kosovo"*Review of Central and East European Law* Vol. 43 Issue 3 (2018);
- Enver Hasani, Fisnik Korencia & Dren Doli, "Individual Complaint Mechanism as a Means to Protecting Fundamental Human Rights and Freedoms: The Case of the Constitutional Court of Kosovo". *European Yearbook of Human Rights* (Intersentia: The Hagues, 2012);
- Enver Hasani, *The Evolution of Succession Process in Former Yugoslavia*, botuar në *Tomas Jefferson Law Review,* Vol. 29, No. 1 2006; ribotuar me leje të autorit edhe në Miskolc Journal of International Law Vol. 4 No. 2, 2007 (Hungari);
- Epaminondas Spiliotopoulos, "Judicial Review of Legislative Acts in Greece". Temple Law Quarterly Vol. 56 No. 2 (1983);
- Ergun Özbudun, "Ottoman Constitution of 1876"*Max Planck Encyclopedia of Comparative Constitutional Law* (Article last updated: May 2016);
- Eric Stein, "International Law in Internal Law: Towards Internationalization of Central – Eastern European Constitutions". *American Journal of International Law* Vol. 88 No. 3 (July 1994);
- Eric Suy, "Unilateral Acts of States as a Source of International Law: Some New Thoughts and Frustrations." Në Olivier Corten, Pierre Klein, Anne Lagerwall, et al., *Droit du pouvoir, pouvoir du droit: Mélanges offerts à Jean Salmon* (Bruylant: Brussels, 2007);
- Ernst J. Cohn, "Precedents in Continental Law". *The Cambridge Law Journal*. Volume 5, Issue 3 (November 1935);
- Esin Örücü, "The Constitutional Court of Turkey: The *Anayasa Mahkemesi* as the Protector of the System". *Journal of Comparative Law* Volume 3, Number 2, 2008;
- Failure to Protect: Anti-Minority Violence in Kosovo, March 2004. *HUMAN RIGHTS WATCH* Vol. 16 No. 6 (July 2004);
- Finsik Korenica, Dren Doli, "Constitutional Rigidity in Kosovo: Significance, Outcomes, and Rationale". *International Law Review Online Companion* Vol. 2 No. 6 (January 2011);
- Fisnik Korenica & Dren Doli, "Taking Care of Strasbourg: The Status of the European Convention on Human Rights and the Case-Law of the European Court of Human Rights in Kosovo's Domestic Legal System" *Liverpool Law Review* Vol. 32 No. 3 (2011);
- Fisnik Korenica & Dren Doli, "The Politics of Constitutional Design in Divided Societies: The Case of Kosovo". *Croatian Yearbook of European Law and Policy*. Vol. 6 No. 6 (2010);
- Fisnik Korenica, Argjend Zhubi, Dren Doli, "The EU-engineered hybrid and international specialist court in Kosovo: How 'special' is it? *European Constitutional Law Review* Vol. 12 Issue 3 (December 2016);
- Francisco Fernandez Segado, "La giustizia costitutzionale nel XXI secolo. Il progressivo avvicinamento dei sistemi americano ed europeo-kelseniano". *Center for Constitutional Studies and Democratic Development Lecture Series* (CLUEB: Bologna, 2010);
- Frank Emmert, "Stare Decisis: A Universally Misunderstood Idea"*Legisprudence* Vol. 6 No. 2 (2012);
- Fruzsina Gárdos-Orosz, "The Hungarian Constitutional Court in Transition – from Actio Popularis to Constitutional Complaint." Acta Juridica Hungarica Vol. 53 No. 4 (December 2012);
- Furkat Zhurakulov, "Separation of Powers in the States of Central Asia and the Caucasus". *Central Asia and the Caucasus* Vol. 12 No. 4 (2011);

- G. A. Harre, "Precedent in Roman Law"*Studies in Philology* Vol. 19, No. 1 (January, 1922);
- Gábor Halmai, "Silence of transitional constitutions: The "invisible constitution" concept of the Hungarian Constitutional Court". *International Journal of Constitutional Law* Vol. 16 No. 3 (2018);
- Gábor Halmai, "Unconstitutional Constitutional Amendments: Constitutional Courts as Guardians of the Constitution?" *Constellations* Volume 19 No 2 (2012);
- Gábor Halmai, "National(ist) constitutional identity? Hungary's road to abuse constitutional pluralism." EUI Working Paper LAW 2017 / 08 (Italy);
- Gabriella Citroni, "The Specialist Chambers of Kosovo: The Applicable Law and the Special Challenges Related to the Crime of Enforced Disappearance" *Journal of International Criminal Justice* Vol. 14 Issue 1 (March, 2016);
- Gal Dor and Menachem Hofnung, "Litigation as Political Participation". *Israel Studies* Vol. 11, No. 2 (Summer, 2006);
- Gary Jeffrey Jacobsohn, "An unconstitutional constitution? A comparative perspective" *International Journal of Constitutional Law* Vol. 4 no. 3 (July 2006);
- Gennady M. Danilenko, "The New Russian Constitution and International Law", *The American Journal of International Law* Vol. 88 No. 3 (1994);
- Geoffrey Brennan and Jose Casas Pardo, A Reading of the Spanish Constitution (1978). *Constitutional Political Economy* Vol. 2 No. 1 (1991);
- Georg P. Fletcher, "Constitutional Identity". In Michel Rosenfeld (ed.), *Constitutionalism, Identity, Difference, and Legitimacy* (Duke University Press: Durham and London, 1994);
- George Joffe, "Morocco: Monarchy, Legitimacy and Succession". *Third World Quarterly* Vol. 10 Issue 1 (1988);
- George N. Sfeir, Modernization of the Law in Arab States*: an Investigation into Current Civil, Criminal and Constitutional Law in the Arab World* (Austin & Winfield Publishers: Nevada, *1998* **);**
- Gerald Staberock, "A Rule of Law Agenda for Central Asia" *Essex Human Rights Review* Vol. 2 No. 1 (2005);
- Gerhard Leibholz, "The Federal Constitutional Court in Germany and the 'SouthWest Case'"*The American Political Science Review* Vol. 46, No. 3 (September, 1952);
- Giancarlo Rolla & Tania Groppi, "Between Politics and law: The Development of the Constitutional Review in Italy". Në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective* (Kluwer law International: The Hague, 2010).
- Gideon Sapir, "Constitutional Revolutions: Israel as a Case-Study". *International Journal of Law in Context* Vol. 5 No. 4 (2009);
- Giorgio Agamben, "A Brief History of the State of Exception: An excerpt from *State of Exception*". Në internet: http://www.press.uchicago.edu/Misc/Chicago/009254.html (shikuar në shkurt 2018);
- Giovanni Piccirilli, "Il Presidente Provvisiorio". Në Eduardo Gianfrancesco, Nicola Lupo, and Guido Rivosecchi (eds.), *I Presidenti di Assamblea parlamentare* (Il Mulino: Bologna, 2014);
- Giulia Pili, "La giustizia costituzionale negli Stati Uniti d'America". Në Luca Mezzetti (ed.), *SISTEMI E MODELLI DI GIUSTIZIA COSTITUZIONALE* (CEDAM: Padova, 2009);
- Giuseppe Martinico, "Is the European Convention Going to Be 'Supreme'? A Comparative-Constitutional Overview of ECHR and EU Law before National Courts". *The European Journal of International Law* Vol. 23 No. 2 (2012);
- Gonçalo de Almeida Ribeiro, "Judicial Activism and Fidelity to law". Në Luís Pereira Coutinho, Massimo La Torre & Steven D. Smith (eds.), *Judicial Activism. An Interdisciplinary Approach to the American and European Experiences* (Springer International Publishing: Swit-

zerland 2015);
- Guobin Zhu ”Constitutional Review in China: An Unaccomplished Project or a Mirage?” *Suffolk University Law Review* Vol. 43 No. 3 (2010);
- Gustavo Femandes de Andrad, “Comparative Constitutional law: Judicial Review”. *Journal of Constitutional law* Vol. 3 No. 3 (May 2001);
- H. Kwasi Prempeh, “*Marbury* in Africa: Judicial Review and the Challenge of Constitutionalism in Contemporary Africa”. *Tulane La Review* Vol. 80 No. 1 (2006);
- Hakan Yilmaz, “The International Context”. Në Christian W. Haerpfer, Patrick Bernhagen, Ronald F. Inglehart, Christian Welzel (eds.), *Democratization*. Second Edition (Oxford University Press: Oxford 2019);
- Hamdija Šarkinović, “Pola vijeka ustavnog sudstva u Crnoj Gori”. *MATICA* br. 59 (Podgorica: jesen, 2014);
- Hanna Jamar & Mary Katherine Vigness, “Applying Kosovo: Looking to Russia, China, Spain and Beyond After the International Court of Justice Opinion on Unilateral Declarations of Independence”. *German Law Journal*, Vol. 11, No. 08 (2010);
- Hannah R. Garry, “When Procedure Involves Mattwers of Life and Death: Interim Measures and the European Convention on Human Rights”. *European Public Law* Vol. 7 Issue 3 (September 2001);
- Hannes Treter, “The implementation of judgements of the European Court of Human Rights in Austria”. Në Thomas Barkhuysen, Michiel Leonard van Emmerik and Piet Hein van Kempen (eds,), *The Execution of Strasbourg and Geneva Human Rights Decisions in the National Legal Prder* (Martinus Nijhoff Publishers: The Hague/Boston /London, 1999);
- Hans G. Rupp, “Federal Constitutional Court in Germany: Scope of Its Jurisdiction and Procedure”. *Notre Dame Law Review* Vol. 44 Isue 4 (1969);
- Hans Kelsen, “Judicial Review of Legislation: A Comparative Study of the Austrian and the American Constitution”. *Journal of Politics* Vol. 4 No.2 (May, 1942);
- Hans Kelsen, “Ko treba da bude cuvar ustava” Në Slobodan Samardzic (ed.), *Norma i Odluka,* fq. 257-297 (Titulli në original: Hans Kelsen, *Wer soll der huter der verfassung sein?* (Dr. Walther Rothschild, Berlin-GruNewald, 1931);
- Hans Smit, “The Terms of Jurisdiction and Competence in Comparative Law”. *The American Journal of Comparative Law*, Vol. 10, Issue 1-2 (Winter-Spring 1961);
- Haxhi Gashi, “Konflikti Lidhur me Privatizimin e Ndërmarrjeve Shoqerore: Ndryshimi i Ligjit për Dhomën e Veçantë të Gjykates Supreme, i Ligjit për AKP-në dhe Ligjet Relevante (“The Conflict of Laws Concerning the Socially Owned Enterprises”). *E drejta/Law* (Fakulteti Juridik, Prishtinë) Nr. 2/2011;
- Hector Fix Zamudio, “The Writ of Amparo in Latin America”. *University of Miami Inter-American law Review* Vol. 13 Issue 3 (1981);
- Heinz Klug, “South Africa’s Constitutional Court: Enabling Democracy and Promoting Law in the Transition from Apartheid.” *Journal of Comparative Law* Vol. III Issue 2 (2008);
- Helmut Steinberger, “Models of Constitutional Jurisdiction” Në European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Science et technique de la démocratie no. 2. CDL-STD(1993)002*. Original. English (Strasbourg 1993). Në internet: http://www.venice. coe. int/ web forms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-STD(1993)002-e (shikuar në shkurt 2018);
- Henry Paul Monaghan, “Stare Decisis and Constitutional Adjudication”. *Columbia Law Review* Vol. 88 No. 4 (May, 1988);
- Henryk Streit, “Iudex Suspectus czy Inhabilis? Studium przypadku”. *Roczniki Wydziału Nauk Prawnych i Ekonomicznych KUL*. Publisher: Towarzystwo Naukowe KUL & Katolicki Uniwersytet Lubelski Jana Pawła II. Vol. 6 Issue 1 (*Pravo*) 2010;
- Herman Schwartz, “Eastern Europe’s Constitutional Courts”. *Journal of Democracy* Vol. 9 No.

4 (1998);

- Herman Schwartz, *The Struggle for Constitutional Justice in Post-Communist Europe* (The University of Chicago Press: Chicago and London, 2000);
- Hootan Shambayati and Güliz Sütçü, "The Turkish Constitutional Court and the Justice and Development Party (2002–09)". *Middle Eastern Studies* Vol. 48 No. 1 (2012);
- Horst Lucke, "Legal history in Australia: The development of Australian legal/historical scholarship". *Australian Bar Review* Vol. 34 No. 1 (2010);
- Hugo Cyr and Monica Popescu, "The Supreme Court of Canada". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* (Cambridge University Press: Cambridge, 2017);
- Igor Spirovski, "The Competence of the Constitutional Court to Control the Conformity of Laws With International Treaties: New Trends in Constitutional Justice." Në European Commission Through Law (Venice Commission) in co-operation with the Constitutional Court of Montenegro and the OSCE, *Seminar on The Competence of the Constitutional Court to Control the Conformity of Laws With International Treaties.* CDL-JU(2009) 036 (Vennice Commission, Strasbourg, 17 November 2009);
- Inga Markovits, "Constitution Making After National Catastrophes: Germany in 1949 and 1990"*William & Mary law Rev* Vol. 49 Issue 9 (2008);
- Is Romania Worse Than Hungary? *The Economist* (OpEd): 17.07.2012. Në internet:http://www.economist.comblogs/easternapproaches/2012/07/romanian-politics;
- Jack E. Frankel, "Removal of Judges: California Tackles an Old Problem." *American Bar Association Journal*, Vol. 49, No. 2 (February 1963);
- Jamal Greene and Yvonne, "Comparative analysis to constitutional history." Në Erin F. Delaney and Rosalind Dixon (eds.), *Comparative Judicial Review*. (Edward Elgar Publishing: UK and USA, 2018);
- James C. Rehnquist, "The Power that Shall be Vested in a Precedent: Stare Decisis, the Constitution and the Supreme Court" *Boston University Law Review* Vol. 66 Nos. 3-4 (May-July 1986);
- James Casey, "The Spanish Constitutional Court" *The Irish Jurist* Vol. 25/27 (1990/1992);
- James E. Moliterno F, "What the ICJ's Decision Means for Kosovars". *German Law Journal,* Vol. 11, No. 08 (2010);
- James E. Pfander, "Removing Federal Judges". *The University of Chicago Law Review* Vol. 74 No. 4 (Fall 2007);
- *Jan Komárek*, "Reasoning with Previous Decisions: Beyond the Doctrine of Precedent" *The American Journal of Comparative Law.* Vol. 61, No. 1 (Winter 2013);
- Jan Zielonka and Alex Pravda, *Democractic Consolidation in Eastern Europe. Vol. 2. International and Transnational Factors* (Oxford University Press: Oxford, 2001);
- Jan Zielonka, *Democractic Consolidation in Eastern Europe. Vol. 1. Institutional Engeneering* (Oxford University Press: Oxford, 2001);
- Janne E. Nijman, "Non-State Actors and the International Rule of Law: Revisiting the" Realist Theory"of International Legal Personality". Në Math Noortmann and Cedri Ryngaert (eds.), *Non-State Actor Dynamics in International Law: From Law-Takers to Law-Makers* (ASHGATE: England, 2010);
- Janneke Gerards, "The European Court of Human Rights". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* (Cambridge University Press: Cambridge, 2017);
- Jean Charpentier, "Engagements unilatéraux et engagements conventionnels: Différences et convergences."Në Jerzy Makarczyk *(ed.), Theory of International Law at the Threshold of the 21st Century: Essays in Honour of Krzysztof Skubiszewski* (Kluwer Law International: The Hague, 1996);

- Jean Didier Siçault, "Du caractère obligatoire des engagements unilatéraux en droit international public."*Revue Général de Droit International Public* 83 (1979);
- Jeffrey Usman, "Non-Justiciable Directive Principles: A Constitutional Design Defect". *Michigan State Journal of International law* Vol. 15 Issue 3 (2007);
- Jerome Alan Cohen, "China's Changing Constitution". *Northwestern Journal of International Law & Business* Volume 1 Issue 1 (Spring1979);
- Jeton SHASIVARI1, "Constitutional Judiciary in the Republic of Macedonia under the shadow of its Fiftieth Anniversary-Situation and Prospects" *ACTA UNIVERSITATIS DANUBIUS* Vol. 9, No.3 (2013);
- Joaquim de Sousa Ribeiro and Esperanca Mealha, "Constitutional Courts as Positive Legislators: Portugal". Në Allan R. Brewer – Caria, *Constitutional Courts as Positive Legislators. A Comparative Law Study* (Cambridge University Press: Cambridge, 2011);
- Joel Colón-Ríos, "Introduction: The forms and limits of constitutional amendments". *International Journal of Constitutional Law* Vol. 13 No. 3 (2015);
- John A.E. Vervaele, "*Ne Bis In Idem*: Towards a Transnational Constitutional Principle in the EU?" Utrecht Law Review Vol. 9 Issue 4 (September 2013);
- John Damis, "Developments in Morocco under the French Protectorate, 1925-1943"*Middle East Journal* Vol. 24 No. 1 (Winter, 1970);
- John Dewey, "The Historic Background of Corporate Legal Personality" *Yale Law Journal* Vol. 35, No. 6 (1926);
- John Dewey, *Logical Method and Law*, *Cornell Law Review* Vol. Issue 1 (1924);
- John G. Lexa, "Equality of Franchise under Proportional Representation". *The American Journal of Comparative Law* Vol. 15 No. 3 (1966 - 1967);
- John Henry Merryman and Vincenzo Vigoriti, "*The American Journal of Comparative Law*"Vol. 150 No. 4 (1966 - 1967);
- John M. Maki, *Government and Politics in Japan. A Road to Democracy* (Frederick A. Praeger: New York, 1962);
- John N. Hostettler and Thomas W. Washburne, "The Constitution's Final Interpreter: We the People."*Regent University Law Review.* Vol. 8 (Spring, 1997);
- John Williamson, "What Washington Means by Policy Reform." Në John Williamson (ed.), Latin American Readjustment: How Much Has Happened (Institute for International Economics: Washington, 1989);
- Jon Elster, "Forces and Mechanisms in the Constitution - Making Process" *Duke law Journal* Vol. 45 Issue 2 (November 1995);
- Jonathan Bond, "Concerning Constitutional Courts in Central and Eastern Europe"*International Public Policy Review* Vol. 2 No. 2 (November 2006);
- Jopseph Marko, "Five Years of Constitutional Jurisprudence in Bosnia and Herzegovina: A First Balance."*European Diversity and Autonomy Papers 7/2004;*
- Jörg Luther, "Realism and Idealism in the Italian Constitutional Culture". Në Maurice Adams, Anne Meuwese, Ernst Hirsch Ballin (eds.), *Constitutionalism and the Rule of law. Bridging Idealism and Realism* (Cambridge University Press: Cambridge, 2017);
- Jorge A. Vargas, "1996 The Rebirth of the Supreme Court of Mexico: An Appraisal of President Zedillo's Judicial Reform of 1995". *Indiana Journal of Global Legal Studies* Vol. 16 Issue 1 (Winter 2009);
- Joseph J. Arvay, Q.C., Sheila M. Tucker and Alison M. Latimer, "Stare Decisis and Constitutional Supremacy: Will Our Charter Past Become an Obstacle to Our Charter Future?". *The Supreme Court Law Review: Osgoode's Annual Constitutional Cases Conference* Vol. 58. (2012);
- Joseph Marko, "The New Kosovo Constitution in a Regional Comparative Perspective". *Review of Central and East European Law* Vol. 33 No. 4 (2008);

- Journal Article, "The Constitution of the Republic of Turkey (1961)". *Islamic Studies* Vol. 2 No. 4 (December 1963);
- *Journal of Libertarian Studies* Volume 18, no. 1 (Winter 2004);
- Judicial Review in Taiwan: A Comparative Perspective, në Dennis T. C. Tang, "Judicial Review and Transition of Authoritarianism in Taiwan". A paper presented at *International Conference on the Transformation of an Authoritarian Regime: Taiwan in the Post-Marital Law Era* (Taiwan Studies Promotion Committee, Taipei, Academia Sinica, April 1-3, 1999;
- Juliano Zaiden Benvindo, *On the Limits of Constitutional Adjudication Deconstructing Balancing and Judicial Activism* (Springer-Verlag: Berlin Heidelberg, 2010)
- Julien Bonnet, "Les instruments du contrôle de constitutionnalité". *La Revue administrative* 56e Année, No. 335 (Septembre 2003);
- Kai Eide, "Kosovo: the way forward". *NORTH ATLANTIC TREATY ORGANIZATION*. 01 Oct. 2004;
- Kaius Tuori, "Hadrian's Perpetual Edict: Ancient Sources and Modern Ideals in the Making of a Historical Tradition." *The Journal of Legal History* Volume 27 Issue 3 (December 2006);
- Karel Vasak, "A 30-year struggle: The sustained efforts to give force of law to the Universal Declaration of Human Rights". *The UNESCO Courier XXX*, no. 11 (1977);
- Karl Smit, "Cuvar Ustava". Në Slobodan Samardzic (ed.), *Norma i Odluka. Karl Smit i njegovi kriticari* ("Filip Visnjic": Beograd, 2001). Titulli i origjinalit: Carl Schmitt, "Der Huter der Verfasung". A*rchiv des offentlichen rechts*. Neue Folge 16 Band J.C.B. Mohr (Paul Siebeck), Tubingen 1929;
- Karl Zemanek, "Unilateral Legal Acts Revisited." Në Karel Wellens *(ed.), International Law: Theory and Practice; Essays in Honour of Eric Suy*. (Martinus Nijhoff: The Hague, 1998);
- Katalin Kelemen, "Appointment of Constitutional Judges in a Comparative Perspective – with a Proposal for a New Model for Hungary". *Acta Juridica Hungarica* Vol. 54 No. 1 (2013);
- Keenan D. Kmiec, "The Origin and Current Meanings of Judicial Activism". *California law Review* Vol. 92 No. 5 (October 2002)
- Keith Hand, "Resolving Constitutional Disputes in Contemporary China". *University of Pennsylvania East Asia Law Review Vol. 7 Issue 1* (2012);
- Keith S. Rosenn, "Judicial Review in Brazil: Developments under the 1988 Constitution." *Southwestern University Journal of Law and Trade in Americas* Vol. 7 (2000);
- Keith S. Rosenn, "Recent Important Decisions by the Brazilian Supreme Court". *The University of Miami Inter American law Review* Vol. 45, No. 2 (Spring 2014);
- Keith S. Rossen, "Judicial Review in Latin America". *Ohio State Law Journal* Vol 35 No. 4 (1974);
- Kemal GÖZLER, "La question de la hierarchie entre les normes constitutionnelles". *Annales de le Faculté de droit d'İstanbul,* Vol. XXXII, No.48, 1998;
- Kermit L. Hall (ed.), *Major Problems in American Constitutional history. Documents and Essays. Vol. I: The Colonial Era Therough Reconstruction* (D.C. Heath and Company: Lexington, Massachusetts and Toronto, 1992);
- Kevin C. Milne, "The Doctrine Of Judicial Privilege: The Historical And Constitutional Basis Supporting A Privilege For The Federal Judiciary" *Washington and Law Review* Vol. 44 No. 1 (1987);
- Kim Lane Scheppele, "A Comparative View of the Chief Justice's Role. Guardians of the Constitution: Constitutional Court Presidents and the Struggle for the Rule of Law in Post-Soviet Europe". *The University of Pennsylvania Law Review* Vol. 154 Issue 6 (2006);
- Kim Lane Scheppele, "Constitutional Negotiations: Political Contexts of Judicial Activism in Post-Soviet Europe". *International Sociology* Vol. 18 No. 1 (March 2003);
- Kim Lane Scheppele, The New Hungarian Constitutional Court. After Solyom, Retreat into Formalism?" *East European Constitutional Review* Vol. 81 No. 1 (Fall 1999);

- Kirill M. Bumin, "Judicial Institutionalization and Judicial Activism of the Post-Communist Constitutional Courts" *Journal of Politics and law* Vol. 10, No. 2 (2017)
- Konrad Lachmayer, "The Austrian Constitutional Court". Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning;*
- Konrad Lachmayer, "The Austrian Constitutional Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* (Cambridge University Press: Cambridge, 2017);
- Konstantsin Dzehtsiarou and Filippo Fontanelli, "Unprincipled Disobedience to International Decisions: A Primer from the Russian Constitutional Court". Në Wolfgang Benedek, Philip Czech, Lisa Heschl, Karin Lukas and Manfred Nowak (eds.), *European Yearbook on Human Rights;*
- Kornizë Kushtetuese për Vetëqeverisje në Kosovë (15 maj 2001);
- Krčinski Blaže, "Ustavna žalba kroz jurispudencije ustavnog suda Makedonije". *Zbornik Radova Pravnog Fakulteta u Nišu* br. 64 (2013);
- Krenar Gashi, "Nations in Transit 2012: Kosovo". *Freedom House* (2012);
- Kriszta Kovács, "Hungary's Orbánistan: A Complete Arsenal of Emergency Powers, VerfBlog, 2020/4/06". Në internet: https://verfassungsblog.de/hungarys-orbanistana-complete-arsenal-of-emergency-powers/. (shikuar në prill 2020);
- Kurt A. Raaflaun, "Early Greece" dhe David J. Philips, "Athenes", botuar në Benjamin Isakhan and Stephen Stockwll (eds.), *The Edinburgh Companion to the History of Democracy. From Pre-Hsitory to Future Possibilities* (Edinburgh University Press: Edinburgh, 2015);
- Kurt H. Nadelmann, "The Judicial Dissent: Publication v. Secrecy" *The American Journal of Comparative Law* Vol. 8 No. 4 (Autumn, 1959);
- Kushtrim Istrefi and Visar Morina, "Judicial Application of International Law in Kosovo" Në Sinisa Rodin & Tamara Pwrisin (eds.), *Judicial Application of International Law in Southeast Europe* (Springer-Verlag Berlin Heidelberg, 2015);
- Laurence Burgorgue-Larsen, "Interim measures in the European system of Human Rights. *Inter-American and European Human Rights Journal* Vol. 2 No. 1-2 (2009);
- Laurence Lockhart, "The Constitutional Laws of Persia: An Outline of Their Origin and Development". *Middle East Journal* Vol. 13 No. 4 (Autumn, 1959);
- Lawrence A. Alexander, "Judicial Activism: Clearing the Air and the Head". Në Luís Pereira Coutinho, Massimo La Torre & Steven D. Smith (eds.), *Judicial Activism. An Interdisciplinary Approach to the American and European Experiences* (Springer International Publishing: Switzerland 2015);
- Lawrence Collins, "Provisional and protective measures in international litigation". *Recueil des cours. Académie de droit international de La Haye* Vol. 234 No 3 (1992);
- Lech Garlicki and Zofia A. Garlicki, "External Review of Constitutional Amendments? International Law as a Norm of Reference". *Israel Law Review*, Vol. 44, No. 3 (2012);
- Lech Garlicki and Zofia A. Gralicka, "Review of Constitutionality of Constitutional Amendments (An Imperfect Response to Imperfections)". Në *Jorurnal of Constitutional Law/Revue De Droit Constitutionnel,* Vo. I, Issue 1 (Istanbul, Turkey: Year 2012);
- *Lech Garlicki, "Constitutional corts versus supreme courts". International Journal of Constitutional Law* Vol. 5 No.1 (January, 2007);
- Lee Epstein, Jack Knight & Olga Shvetsova, (2001)"The Role of Constitutional Courts in the Establishment and Maintenance of Democratic Systems of Government". *Law and Society Review*. Vol. 35 No. 1 (2001);
- Leonard F.M. Besselink, "National and constitutional identity before and after Lisbon". *Utrecht Law Review* Volume 6, Issue 3 (November) 2010;
- Leonid Nikitinsky me Boris Ebzeev me titull" Justice of the Constitutional Court of the Russian

Federation", botuar në *East European Constitutional Review* Vol. 6 No. 1 (1997);

- Leslie W. Abramson, "Deciding Recusal Motions: Who Judges the Judges?". *Valparaiso University Law Review* Vol. 28 No. 2 (1994);
- Lisa Hilbink, "Assessing the New Constitutionalism". *Comparative Politics* Vol. 40 No. No. 2 (January 2008);
- Lize R. Glas, "The Boundaries to Dialogue with the European Court of Human Rights: Exploring Patterns of Repetitive Violations". *European Yearbook of Human Rights* (2018);
- Louis Aucoin, "Views from the Field On Constitution Writing: The Case of Kosovo (Interview)". *PRAXIS: The Fletcher Journal of Human Security.* Vol. XXIII (2008);
- Louis M. Aucoin, (1992) "Judicial Review in France: Access of the Individual Under French and European Community Law in the Aftermath of France's Rejection of Bicentennial Reform". *Boston College International and Comparative Law Review*. Vol. 15 Issue 2 (1992);
- Luc Heuschling, "Edouard Lambert. Le gouvernement des juges et la lutte contre la législation sociale aux États-Unis. L'expérience américaine du contrôle judiciaire de la constitutionnalité des lois". *Revue internationale de droit comparé.* Vol. 59 N°4 (2007);
- Lucia Dalla Pellegrina, Nuno Garoupa & Shirley Ching-ping Lin, "Judicial Ideal Points in New Democracies: The Case of Taiwan." *National Taiwan University Law Review* Vol. 7 No. 1 (2012);
- Luis García-Corrochano Moyano, "Competence and Jurisdiction in Public International Law: International Courts in the Americas". Në Nerina Boschiero, Tullio Scovazzi, Cesare Pitea & Chiara Ragni (eds.), *International Courts and the Development of International Law Essays in Honour of Tullio Treves* (SPRINGER. The Hague, 2013);
- Luis Lopez Guerra, "The Role and Competences of the Constitutional Court". Në European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *The Role of the Constitutional Courts in the Consolidation of the Rule of Law*. (UniDem Seminar Bucharest, 8-10 June 1994). *CDL-STD (1994) 010*;
- Luís Pereira Coutinho, "The Passive Sovereignty of the Constitutional Judge a State Theory Approach". Në Luís Pereira Coutinho, Massimo La Torre & Steven D. Smith (eds.), *Judicial Activism. An Interdisciplinary Approach to the American and European Experiences* (Springer International Publishing: Switzerland 2015);
- Luisa Azzena, "La giustizia costituzionale in Portogallo". Në J. Luther - R. Romboli - R. Tarchi (eds.), *Esperienze di giustizia costituzionale*: *Portogallo, Spagna, Belgio, Russia Polonia, Romania, Ungheria*. Tommo II (Giappichelli: Torino, 2000);
- Lynn Berat, "Courting Justice: A Call for Judicial Activism in a Transformed South Africa" *Saint Louis University law Journal* Vol. 37 No. 4 (Summer 1993);
- M. Pasqualucci, "Interim Measures in International Human Rights: Evolution and Harmonization". *Vanderbilt Journal of Transnational Law* Vol. 38 No. 1 (January 2005);
- Maartje de Visser, "A Critical Assessment of the Role of the Venice Commission in Processes of Domestic Constitutional Reform". *The American Journal of Comparative Law* Vol. 63 Issue 4 (October 2015);
- *Maja Nastić*, "Constitutional Review of International Agreements: Comparative Law Perspective". FACTA UNIVERSITATIS: University of Niš, Faculty of Law, Serbia. Law and Politics Vol. 13 No. 1 (2015);
- Malcolm Evans, "The Italian Constitutional Court". *The International and Comparative Law Quarterly* Vol. 17 No. 3 (July, 1968);
- Marc Weller, "The Rambouillet Conference on Kosovo", *International Affairs* Volume 75, Issue 2 (April 1999);
- Marcin Matczak, Matyas Bencze and Zdenek Kuhn, "Constitutions, EU law and Judicial Strategies in the Czech Republic, Hungary and Poland" *Journal of Public Policy* Vol. 30 Issue 1 (April 2010);

- Maria Dicosola, Cristina Fasone & Irene Spigno, "The Prospective Role of Constitutional Courts in the Advisory Opinion Mechanism Before the European Court of Human Rights: A First Comparative Assessment with the European Union and the Inter-American System" *German Law Journal* Vol. 16 No. 6 (2015);
- Marian Ahumada Ruiz, "The Spanish Constitutional Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* (Cambridge University Press: Cambridge, 2017);
- Marie - Claire Ponthoreau and Fabrice Hourquebie, "France: The French Conseil Constitutionel: An Evolving Form of Constitutional Justice". Në Andrew Harding and Peter Leyland (eds.), *Constitutional Courts. A Comparative Study* (Wildy, Simmonds & Hill Publishing: London, 2009);
- Marie - Claire Ponthoreau and Jacques Ziller, "The Experience of the French Conseil Constitutionel: Political and Social Context and Current Legal-Theoretical Debates". Në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West. Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post – Communist Europe in a Comparative Perspective* (Kluwer Law International: The Hague, 2010);
- Mario Mendez, "Constitutional Review of treaties: Lessons from comparative constitutional design and practice". *International Journal of Constitutional Law* Vol. 15 No. 1 (2017);
- Mark Brzeziński" The Emergence of Judicial Review in Eastern Europe: The Case of Poland." *The American Journal of Comparative Law* Vol. 41 No. 1 (Winter 1993);
- Mark F. Brzezinski, Leszek Garlicki, "Judicial Review in Post-Communist Poland: The Emergence of a Rechtsstaat?, "*Stanford Journal of International Law Vol.* 31 No. 1 (1995);
- Mark Franek, "Judicial Activism. A Tempest or a Tempest in a Teapot?" *The Philadelphia lawyer* (Summer 2014) fq. 40-42 në fq. 40. Në internet:http://www.philadelphiabar.org/WebObjects/PBARead Only.woa/ Contents/WebServerResources/CMSR esources/TPL_Summer14_Teapot.pdf;
- Mark Gould, "Islam, the Law, and the Sovereignty of God". *Policy Review* Issue 149 (June–July 2008);
- Mark S. Hurwitz, "Judges and the Rule of Necessity: *Ignacio* and the Ninth Circuit's Judges". *The Justice System Journal,* Vol. 28, No. 2 (2007);
- Mark Tushnet, "Authoritarian Constitutionalism". *CORNELL LAW REVIEW* Volume 100 Issue 2 (January 2015);
- Marrëveshja e Rambujesë – Marrëveshja e përkohshme për paqe dhe vetëqeverisje në Kosovë (shkurt – mars 1999);
- Marta Cartabia, "The Italian Constitutional Court and the Relationship between the Italian Legal System and the European Community". *Michigan Journal of International Law*. Vol. 12 Issue 1 (Fall 1990);
- Martin Petrin, "Reconceptualizing the Theory of the Firm -From Nature to Function". Penn. State Review Vol. 118 No. 1 (Summer, 2013);
- Massimo Cavino (ed.), *Esperienze di diritto vivente. La giurisprudenza negli ordinamenti di diritto legislativo. Vol. 1. Italia, Francia, Belgio,Germania, Spagna, Portogallo, Brasile, Argentina, Colombia* (Giuffrè Edittore: Milano, 2009);
- Massimo La Torre, "Between Nightmare and Noble Dream: Judicial Activism and Legal Theory". Në Luís Pereira Coutinho, Massimo La Torre & Steven D. Smith (eds.), *Judicial Activism. An Interdisciplinary Approach to the American and European Experiences* (Springer International Publishing: Switzerland 2015);
- Masuda Tomo (translated by A. Fraser), "The Meiji Constitution: Theory and Practice". East Asian History Vol. 1 (June 1991);
- Mattheë E. Cross, "Equipping the Specialist Chambers of Kosovo to Try Transnational Crimes:

Remarks on Independence and Cooperation" *Journal of International Criminal Justice* Vol. 14 Issue 1 (March, 2016);

- Mauro Cappelletti, "Judicial Review in Comparative Perspective". Në *California Law Review* Vol. 58 Issue 5 (October 1970);
- Max Radin*, "*Le Gouvernement des Juges et la Lutte Contre la Législation Sociale aux Etats-Unis by Edouard Lambert"*California law Review* Vol. 11, No. 1 (Nov., 1922);
- Mel A. Topf, "The Jurisprudence of the Advisory Opinion Process in Rhode Island" *Roger Williams University Law Review* Vol. 2 issue 2 (Spring, 1997);
- Melville B. Nimmer, "The Uses of Judicial Review in Israel's Quest for a Constitution". *Columbia Law Review* Vol. 70, No. 7 (1970);
- Michael B. Wise, "Cuba and Judicial Review". *Southwestern Journal of Law and Trade in the the Americas* Vol. 7 No. 2 (2000);
- Michael B. Wise, "Judicial Review and Its Politicization in Central America: Guatemala, Costa Rica, and Constitutional Limits on Presidential Candidates". *Santa Clara Journal of International Law* Vol. 7 Issue 2 (2010);
- Michael Bothe, "Kosovo – So What? The Holding of the International Court of Justice Is Not the Last Word on Kosovo's Independence". *German Law Journal,* Vol. 11, No. (2010);
- Michael K. Addo, "Interim Measures of Protection for Rights Under the Vienna Convention on Consular Relations". *European Journal of International Law* Vol. 10 No 4 (1999);
- Michael Krykov, "Self-Determination From Marx to Mao" *Ethnic and Racial Studies* Vol. 19 No. 2 (April 1996);
- Michaela Hailbronner and Stefan Martini, "The German Federal Constitutional Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning Reasoning* (Cambridge University Press: Cambridge, 2017);
- Michel Rosenfeld, "Constitutional Identity". Në Michel Rosenfeld and Andras Sajo (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law* (Oxford University Press: Oxford, 2012);
- Michele Beletti, "Il sistema di giustizia costituzionale portoghese". Në Luca Mezeti (ed.), *SISTEMI E MODELLI DI GIUSTIZIA COSTITUZIONALE* (CEDAM: Padova, 2009);
- Miguel Schor "An Essay on the Emergence of Constitutional Courts: The Cases of Mexico and Columbia". *Indiana Journal of Global Legal Studies* Volume 16 Issue 1 (Winter 2009);
- Mirosal Cerar, "Slovenia's Constitutional Court Within the Separation of Power". Në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective* (Kluwer Law International: The Hague, 2010);
- Mo Jihong, "The Constitutional Law of the People's Republic of China and Its Development". *Columbia Journal of Asian Law* Vol. 23 No. 1 (Fall 2009);
- Mohamed Abdelaal, "Religious Constitutionalism in Egypt: A Case Study". *The Fletcher Forum of World Affairs* Vol. 37 Issue 1 (Winter 2013);
- Muhammad Zubair and Sadia Khattak, "A comparative analysis of legal system in central Asia: from pre-tsarist period to soviet Russia" *WALIA journal* 31(S6) (2015);
- Myriam Hunter-Henin, Constitutional Developments and Human Rights in France: One Step Forward, Two Steps Back, *The International and Comparative law Quarterly* Vol. 60, No. 1 (January 2011);
- Nathan J. Brown & Clark B. Lombardi, "The Supreme Constitutional Court of Egypt on Islamic Law, Veiling and Civil Rights: An Annotated Translation of Supreme Constitutional Court of Egypt Case No. 8 of Judicial Year 17 (May 18, 1996)";
- Nathan J. Brown and Julian G. Waller, "Constitutional courts and political uncertainty: Con-

stitutional ruptures and the rule of judges. *International Journal of Constitutional Law* Vol. 14 No. 4 (2016);

- Nathan J. Brown and Mara Revkin, "Islamic Law and Constitutions". Në Anver M. Emon and Rumee Ahmed (ed.) *The Oxford Handbook of Islamic Law* (Online Publication Date: Nov 2015 DOI: 10.1093/ oxfordhb /97801996 79010. 013.27);
- Nathan J. Brown, "Judicial Review and the Arab World". *Journal of Democracy* Vol. 9 No. Issue 4 (1998);
- Nicolas Maziau, "Chronique de jurisprudence de la Court constituionnelle de Bosnie-Herzegovine pour l'anne 1999". Në Giuseppe de Vergottini (ed.) *GIUSTIZIA COSTITUZIONALE E SVILUPO DEMOCRATICO NELL PAESI DEL' EUROPA CENTRO – ORIENTALE* (G. Giappicheilli Editore – Torino, 2000);
- Nigel Foster & Satish Sule, *German Legal System and Laws*. Fourth Edition (Oxford University Press: Oxford, 2010);
- Nuno Garoupa, Veronica Grembi and Shirley Ching-ping Lin, "Explaining Constitutional Review in New Democracies: The Case of Taiwan". *Pacific Rim Law& Policy Journal* Vol. 20 No. 1 (January 2011);
- *Occasional Papers/Reprints Series in Contemporary Asian Studies* Vol. 33 No. 4 (1980) (School of Law of the University of Maryland);
- Oliver Jouanjan, "Aprecu d'une historie des fonctions de justice constitutionnelle en Allemagne (1815-1933)". Në Constance Grewe, Oliver Jounjan, Eric Maulin, Patric Wachsmann (eds.), *La notion de"justice constitutionnelle"* (Dalloz: Paris, 2005);
- Olman A. Rodriguez L., "The Costa Rican Constitutional Jurisdiction*"Duquesne Law Review* Vol. 49 No. 2 (Spring 2011);
- *ON THE LAW ON THE ESTABLISHMENT AND RULES OF PROCEDURE OF THE CONSTITUTIONAL COURT OF TURKEY*. Adopted by the Venice Commission at its 88th Plenary Session (Venice, 14-15 October 2011). Opinion No. 612 / 2011. CDL-AD(2011) 040 (Strasbourg, 18 October 2011);
- Or Bassok and Yoav Dotan, "Solving the countermajoritarian difficulty?" *International Journal of Constitutional Law*, Volume 11, Issue 1 (January 2013);
- Oren Soffer, "Judicial Review of Legislation in Israel: Problems and Implications of Possible Reform. *Israel Affairs* Vol. 12 No. 2 (2006);
- Oisín Tansey, Kosovo: Independence and Tutelage. *Journal of Democracy* Vol. 20 No. 2 (2009);
- P. H. Kooijmans, "Human Rights – Universal Panacea? Some Reflections on the So-called Human Rights of the Third Generation" *Netherlands International Law Review* Vol. 37 No. 3 (1990);
- Petar Bačić, "Ustavna demokracija i sudska uzurpacija ustava." *Zbornik radova Pravnog fakulteta u Splitu*. God. 46 Br. 3 (2009);
- P.E. Corbett, M. A., "The Legislation of Hadrian" *University of Pennsylvania Law Review* Vol.; 75 No. 8 (June 1926);
- Paolo Carroza, "Il diritto socialista". In P. Carrozza, A. Di Giovine & G. F. Ferrari (eds.), *Diritto costituzionale comparato* (GLF Editori Laterza: Roma-Bari, 2009);
- Paolo Damiani, "La giustizia costituzionale in Australia"; & Caterina Drigo, "La giustizia costituzionale in Canada". Në Luca Mezzetti (ed.), Sistemi e modelli di giustizia costituzionale (CEDAM: Padova, 2009);
- Paolo Passaglia, "Rights-Based Constitutional Review in Italy". Relazione svolta a *The Society of Legal Scholars Annual Seminar* 2013, svoltosi a Dublino il 2 e 3 luglio 2013. Në internet: http://www.giurcost.org/studi/Passaglia4.pdf;
- Paolo Passaglia, "The Italian system of constitutional Review: A Kelsenian model moving towards a decentralized model". Në John Bell, Marie – Luce Paris (eds.), *Rights Based Con-*

stitutional Review. Constitutional Courts in Changing Landscape (Edward Elgar: UK & USA, 2016);

- Patricia A. Essoff, "Finland v. Denmanrk: A Call to Clarify the International Court of Justice's Standards for Provisional Measures". *Fortham International Journal Law Journal* Vol. 15 Issue 3 (1991);
- Patricio Navia & Julio Rios - Figueroa, "The Constitutional Adjudication Mosaic of Latin America." *Comparative Political Studies* Vol. 38 Issue 2 (2005);
- Patrick Peeters and Jens Mosselmans, "The Constitutional Court of Belgium: Safeguard of the Autonomy of the Communities and Regions". Në Nicholas Aroney and John Kincaid (eds.), *Courts in Federal Countries: Federalists or Unitarists?* (University of Toronto Press: Toronto, 2017);
- Paul Anthony McDermott, "The Separation of Powers and the Doctrine of Non-Justiciability". *The Irish Jurist* New Series, Vol. 35 (2000);
- Paul Craig, "Transnational Constitution-Making: The Contribution of the Venice Commission on Law and Democracy'. *UC Irvine Journal of International, Transnational, and Comparative Law* Vol. 2 (2017);
- Paul L. McKaskle, "The European Court of Human Rights: What It Is, How It Works, and Its Future". *University of San Francisco law Review* Volume 40 Issue 1 (Fall 2005);
- Pavle Nikolic, "La Justice constitutionnelle en Yougoslavie." Në Giuseppe de Vergottini (ed.) *GIUSTIZIA COSTITUZIONALE E SVILUPO DEMOCRATICO NELL PAESI DEL' EUROPA CENTRO – ORIENTALE* (G. Giappicheilli Editore – Torino, 2000);
- Peter Leyland, "The multifaceted constitutional dynamics of U.K. devolution*". International Journal of Constitutional law* Vol. 9 No. 1 (2011);
- Petersmann, Ernst-Ulrich, "Human Rights, International Economic Law and 'Constitutional Justice'". European Journal of International Law Vol. 19 No. 4 (2008);
- **Pierre Pescatore,** *Conclusion et effet des traités internationaux: selon le droit constitutionnel, les usages et la jurisprudence du Grand-duché de Luxembourg*. Office des Publications de l'Etat: Louxembourg, 1964 &, ripublikuar në Bruylant: Bruxelles, 2009);
- Polazne osnove za preuređenje odnosa Srbije i Crne Gore u okviru državne zajednice"(Beogradski Sporazum), *Međunarodna politika*, Dokumenti, Beograd, br. 1105, 2002;
- Portugal's Constitution of 1976 with Amendments through 2005. Në internet: https://www.constituteproject.org/constitution/Portugal_2005.pdf (shikuar në prill 2018);
- Professor C. Economides, "The Relationship Between International and Domestic Law"*, Science and Technique of Democracy*, No. 6, CDL – STD 006 (Vennice Commission: Strasbourg, 1993);
- Projekt-Kushtetuta qe përkthyer në të gjitha gjuhët amëtare të Kosovës dhe ishte gati kur erdhi dita e pavarësisë në shkurt të vitit 2008. John Tunheim, "Rule of Law and the Kosovo Constitution"*Minnesota Journal of International Law* Vol. 18 Issue 2 (2009);
- R. de Lange & P.A.M. Mevis, "Constitutional Guarantees for the Independence of the Judiciary"*Electronic Journal of Comparative Law* Vol. 11 No. 1 (May 2007);
- Rafaâ Ben Achour, "La Constitution tunisienne du 27 janvier 2014." *Revue française de droit constitutionnel* Vol. 4 No. 100 (2014);
- Rafaâ Ben Achour, Sana Ben Achour, "LA TRANSITION DÉMOCRATIQUE EN TUNISIE: ENTRE LÉGALITÉ CONSTITUTIONNELLE ET LÉGITIMITÉ RÉVOLUTIONNAIRE". *Revue française de droit constitutionnel* Vol. 4 No. 92 (2012);
- Ralf Rogowski and Thomas Gawron, "Constitutional Litigation as Dispute Processing: Comparing the U.S. Supreme and the German Federal Constitutional Court". Në Ralf Rogowski and Thomas Gawron (eds.), *Constitutional Courts in Comparison: The U.S. Supreme Court and the German Federal Constitutional Court* (Berghan Books: New York and Oxford, 2002);

- Renata Uitz, "Constitutional Courts in Central and Eastern Europe: What Makes a Question Too Political?" *Juridica International* Vol. 13 No. 47 (2007);
- Republic of Kenya. In the Supreme Court of Kenyaat Nairobi *(Coram: Mutunga, CJ;Rawal, DCJ;Tunoi, Ibrahim, Ojwang, Wanjala&Ndungu, SCJJ).* Advisory Opinion Reference No. 2 of 2013. Në internet: *http://kenyalaw.org/caselaw/cases/ view/91815/ (shikuar në janar 2018);*
- Republika e Kosovës/Gjykata Themelore në Prishtinë/ Departamenti i Krimeve të Rënda/ FTESË. PPRKR nr.130115 / Më dt. 07.05.2015;
- Rett R. Ludwikowsk "Constitution Making in the Countries of Former Soviet Dominance: Current Development." *Georgia Journal of International and Comparative Law* Vol. 23 No. 2 (1993);
- Rett R. Ludwikowski, "Constitutional Culture of the New East-Central European Democracies". *Georgia Journal of International & Comparative Law*. Vol. 29 No 1 (2000);
- Rhett Ludwikowski, "Judicial Review in the Socialist Legal System: Current Developments" *The International and Comparative Law Quarterly,* Vol. 37, No. 1 (Jan., 1988);
- Richard Davis & D Jeffrey Burnham, "The Role of the Federal Judiciary in the Development of Federalism in West Germany and the United States". *Boston College International and Comparative Law Review* Vol. 12 Issue 1 (1989);
- Rivka Weill, "Hybrid Constitutionalism: The Israeli Case for Judicial Review and Why We Should Care". *Berkely Journal of International Law* Vol. 30 No. 2 (2012);
- Rize L. Glas, "The Bpundaries to Dialogue with the European Court of Human Rights". Në Wolfgang Benedek, Philip Czech, Lisa Heschl, Karin Lukas and Manfred Noëak (eds.), *European Yearbook on Human Rights* (Intersentia: Cambridge, Antwerp, Chicago, Vienna, 2018);
- Robert A. Burt, "Inventing Judicial Review: Israel and America"(1989). *Faculty Scholarship Series;*
- Robert F. Aumann, "The Supreme Court and the Advisory Opinion". *Ohio State Law Journal* Vol. 4 No. 1 (1937);
- Robert Harmsen, "The European Court of Human Rights as a 'Constitutional Court': Definitional Debates and the Dynamics of Reform". Në John Morison, Kieran McEvoy, and Gordon Anthony (eds.), *Judges, Transition, and Human Rights* (Oxford University Press: 2007);
- Robert Howse & Ruti Teitel, "Delphic Dictum: How Has the ICJ Contributed to the Global Rule of Law by its Ruling on Kosovo?" *German Law Journal,* Vol. 11, No. 08 (2010);
- Robert Muharremi, "A Note on the ICJ Advisory Opinion on Kosovo". *German Law Journal,* Vol. 11, No. 08 (2010);
- Robert R. Wilson, "International Law in New National Constitutions". *The American Journal of International Law* 58, no. 2 (1964);
- Roberta Bille, "La giustizia costituzionale in America latina". Në Luca Mezzetti (ed.), *SISTEMI E MODELLI DI GIUSTIZIA COSTITUZIONALE* (CEDAM: Padova, 2009);
- Roberto Romboli, Carmela Salazar, Tania Groppi, Andrea Pertici, Roberto Pinardi and Gianpaolo Parodi, "Il processo costituzionale: la tipologia delle decisioni" *Il Foro Italiano* Vol. 121 No. 3 (Marzo, 1998);
- Ruth Gavison, "What Belongs in a Constitution?" *Constitutional Political Economy* Vol. 13 No. 1 (2002);
- Ruti G. Teitel, "Reactionary Constitutional Identity". Në Michel Rosenfeld (ed.), *Constitutionalism, Identity, Difference, and Legitimacy;*
- Ruti Teitel"Transitional Rule of Law". Në Adam Czamota, Martin Krygeier and Wojciech Sadurski (eds.), *Rethinking the Rule of Law After Communism* (CEU Press: Budapest, 2005);
- Ruti Teitel, "Post-Communist Constitutionalism: A Transitional Perspective" *Columbia Human Rights law Review* Vol. 26 No. 1 (1994);

- Ružica Mrdaković-Cvetković, "*Međunarodni kontinuitet Srbije posle odvajanja Crne Gore". Međunarodni Problemi* (Beograd) Vol. LVIII Br. 3 (July 2008);
- Ryszard Cholewinski, "The Protection of Human Rights in the New Polish Constitution". *Fordham International Law Journal*. Vol. 22 Issue 2 (1998);
- S. B., "The Case for Reversal of Evans v. Gore" *Virginia Law Review* Vol. 25, No. 8 (Jun., 1939);
- Saikrishna Prakash & Steven D. Smith, "Removing Federal Judges Without Impeachment"(-FORUM) *The Yale Law Journal* Vol. 116 (2006-2007);
- Salvatore Sica, "Il valore del precedente: attuale dimensione del diritto 'vivente'". *Federalizmi. it* (Rivista di Diritto Italiano, Comparato, Europeo) n. 18 (2018);
- Sarah Williams, "The Specialist Chambers of Kosovo. The Limits of Internationalization?" *Journal of International Criminal Justice* Vol. 14 Issue 1 (March, 2016);
- Schnutz Rudolf Durr, "Comparative Overview of European Systems of Constitutional Justice". *Vienna Journal on International Constitutional Law,* Vol. 5 Issue 2 (2011);
- Scott Newton, *The Constitutional Systems of the Independent Central Asian States: A Contextual Analysis (Constitutional Systems of the World)* (Hart Publishing: Oxford and Portland, Oregon, 2017);
- *Sentenza 15/1982 of 1 February 1982*. Për komentet e doppia pronuncia, cf. më shumë në Gustavo Zagrebelsky & *Valeria Marcenò, Giustizia costituzionale. Parte seconda: Ogetti, procedimenti, decisioni (Il Mulino: Milano, 2018) fq. 221-226;* Michele Francaviglia, "*Il caso del decreto-legge n. 34/2019: dall'emanazione differita alla"doppia"deliberazione*". *OSSERVATORIO COSTITUZIONALE* ("Assoziacione Italiana Dei Costituzionalisti"). Fasc. 3/2019 Data: 4 giugno 2019;
- Serdar Gülener and İrfan Haşlak, "Relations between Politics and Constitutional Review in Turkey with Special Reference to the Referrals of Republican People's Party: 2002-2010 Period"*ALTERNATIVES: TURKISH JOURNAL OF INTERNATIONAL RELATIONS* Vol. 10 Nos. 2-3 (Summer – Fall, 2011);
- Seth Barrett Tillman, "Interpreting Precise Constitutional Text: The Argument for a"New"Interpretation of the Incompatibility Clause, the Removal & Disqualification Clause, and the Religious Test Clause—A Response to Professor Josh Chafetz's Impeachment & Assassination"*Cleveland State Law Review* Vol. 61 Issue 2 (2013);
- Shannon Ishiyama Smithey and John Ishiyama, "Judicial Activism in Post-Communist Politics", L*aw & Society Review* Vol. 36, No. 4 (2002);
- Sharon Weintal, "The Challenge of Reconciling Constitutional Eternity Clauses With Popular Sovereignty: Toward Three-Track Democracy in Israel as a Universal Holistic Constitutional System and Theory". *Israel Law Review* Vol. 44 No. 3 (2012);
- Shojiro Sakaguchi, "Major constitutional Developments in Japan in the first decade of the twenty –first century". Albert H. Y. Chen, *Constitutionalism in Asia in the Early Twenty – First Century* (Cambridge University Press: Cambridge, 2014);
- Siniša Rodin, "Constitutional Relevance of Foreign Court Decisions". *The American Journal of Comparative Law*, Volume 64, Issue 4 (December 2016);
- Stanley Bach, "The office of speaker in comparative perspective". *The Journal of Legislative Studies* Vol. 5 No. 3–4 (1999);
- Stefan Vogenauer, "Precedent, rule of". Në Jurgen Basedow, Klaus J. Hopt, Reinhard Zimmermann, and Andreas Stier (eds.), *The Max Planck Encyclopedia of European Private Law* (Oxford University Press: Oxford, 2012);
- Stefan Theil, "Is the 'Living Instrument' Approach of the European Court of Human Rights Compatible ëith the ECHR and International law?" *European Public law* Vol. 23 Issue 3 (2017);
- Stefano Evangelista and Giovanni Canzio, "Corte di cassazione e diritto vivente"*Il Foro Italiano* Vol. 128 No. 4 (Aprile 2005);

- Stephen Waddams, "Review: Authority, Precedent, and Principle". *The University of Toronto Law Journal*, Vol. 59, No. 1 (Winter, 2009);
- Steven Gow Calabresi, "The origins and growth of judicial enforcement". Në Erin F. Delaney and Rosalind Dixon (eds.), *Comparative Judicial Review;*
- Steven Hill & Paul Linden-Retek, "Supervised Independence and Post-Conflict Sovereignty: The Dynamics of Hybridity in Kosovo's New Constitutional Court". *The Yale Journal of International Law Online* Vol. 36 No. 38 (Fall 2010);
- Susana de la Sierra, "Provisional Court Protection in Administrative Disputes in Europe: The Constitutional Status of Interim Measures deriving from the right to Effective Court Protection. A Comparative Approach". *European Law Journal* Vol 10 No. 1 (2004);
- Suzie Navot, "Israeli Supreme Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre and Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* (Cambridge University Press: Cam bridge, 2017);
- T. N. Pant, "The Doctrine of 'Res Judicata' Its Import in Constitutional Law" *The Indian Journal of Political Science*, Vol. 25, No. 3/4 (July – September – Decmber, 1964);
- Tamas Gyorfi, "The Supreme Court (House of Lords) of the United Kingdom." Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* (Cambridge University Press: Cambridge, 2017);
- Tamas Gyorfi, "The Supreme Court (The House of Lords) of the United Kingdom". Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning;*
- Tamir Moustafa, "Law Versus the State: The Judicialization of Politics in Egypt". *Law & Social Inquiry* Vol. 28 Issue 4 (2003);
- Tania Groppi and Irene Spingo, "The Constitutional Court of Italiy". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* (Cambridge University Press: Cambridge, 2017);
- Tania Groppi, "The Italian Constitutional Court: Towards a 'Multilevel System' of Constitutional Review?" *Journal of Comparative Law* Vol. III Issue 2 (2008);
- Tarik Olcay, "Firing Bench-mates: The Human Rights and Rule of Law Implications of the Turkish Constitutional Court's Dismissal of Its Two Members Decision of 4 August 2016, E. 2016/6 (Miscellaneous file), K. 2016/12". *European Constitutional Law Review* Vol. 13 Issue 3 (September, 2017);
- *The American Journal of International Law* Vol. 7, No. 2, Supplement: Official Documents (Apr., 1913);
- The S Charles M. Carberry, "tate Advisory Opinion in Perspective" *Fordham Law Review* Vol. 44 Issue 1 (1975);
- Thijmen Koopmans, "Stare Decisis in European Law". Në David O. O'Keeffe & Henry G. Schermers (eds.), *Essays in European Law and Integration: To Mark the Silver Jubilee of the Europa Institute, Leiden 1957-1982* (Kluwer – Deventer: The Netherlands, 1982);
- Thomas Buergenthal, *Modern Constitutions and Human Rights Treaties,* 36 Columbia Journal of Transnational Law Vol. 36 Issue 1 (1997);
- Thomas Burri, "The Kosovo Opinion and Secession: The Sounds of Silence and Missing Links". *German Law Journal,* Vol. 11, No. 08 (2010);
- Thomas Bustamante, & Evalinda De Godoi Bustamante, (2010) "Constitutional Courts as 'negative legislators'. The Brazilian case" *Revista Jurídica Piélagus* Vol. 9 (2010);
- Thomas E. Kellogg, "Constitutionalism with Chinese Characteristics?: Constitutional Development and Civil Litigation in China". *Indiana University Research Center for Chinese Politics & Business*. *Working Paper No. 1* (February 2008);
- Thomas E. Kellogg, Keith Hand, "NPCSC: The Vanguard of China's Constitution?" *China Brief*, Volume 8 Issue: 2 (2008);

- Thomas McKevitt, “, The Rule of Necessity: Is Judicial Non-Disqualification Really Necessary? *Hofstra Law Review* Vol. 24 Issue 3 (1996);
- Tilman Hoppe, “Public Corruption: Limiting Criminal Immunity of Legislative, Executive and Judicial Officials in Europe” *Vienna Journal of International Constitutional Law* Vol. 5 No. 4 (2001);
- Timothy Brennan, “Thomas Jefferson and the Living Constitution”. *The Journal of Politics* Vol. 79 No. 3 (July 2017);
- Timothy M. Stengel, “Absolute Judicial Immunity Makes Absolutely No Sense: An Argument For An Exception To Judicial Immunity” *Temple Law Review* Vol. 84 No. 4 (Summer 2012);
- Tom Campbell, K.D. Ewing, and Adams Tomkins, “Introduction”. Në Tom Campbell, K.D. Ewing, and Adams Tomkins, *The Legal Protection of Human Rights. Skeptical Essays* (Oxford University Press: Oxford, 2011);
- Tom Ginsburg, “Constitutional Courts in East Asia: Understanding Variation.”Në Andrew Harding and Peter Leyland (eds.), *Constitutional Courts. A Comparative Study* (Wildy, Simmonds & Hill Publishin: London, 2009);
- Toma Galli, “Kratka analiza Savjetodavnog misljenja Medjunarodnog suda o proglasenju neovisnosti Kosova s medunarodnim pravom”. *Zbornik Pravnog Fakulteta u Zagrebu,* Vol. 61 No. 6 (Prosinac 2011);
- Toni-Ann Citera, “A Look at the Extrajudicial Source Doctrine under 28 U.S.C. 455”. *Journal of Criminal Law and Criminology* Vol. 85 No. 4 (Spring, 1995);
- Tony A. Freyer, “Cooper v. Aaron:”Incident and Consequence. *The Arkansas Historical Quarterly* Vol. 65, No. 1 (Spring, 2006);
- Ulrich K. Preuss, “The Implications of ‘Eternity Clauses’: The German Experience”. Në *Israel Law Review* Vol. 44 No. 3 (2012);
- Uredba o podeli zemlje na oblasti. *Sluzbene Novine Kraljevine SHS* Br. 92 (26 april 1922);
- Ustav Crne Gore. *Službeni List Crne Gore,* broj 1/07 (Podgorica: 2007);
- Ustav Savezne Republike Jugoslavije, *Službeni List Savezne Republike Jugoslavie*, br. 1/92 (Beograd);
- Valentina Volpe, “Drafting Counter-majoritarian Democracy. The Venice Commission’s Constitutional Assistance”, *Heidelberg Journal for International law, ZaöRV* Vol. 76 No. 4 (2016);
- Veijo Heiskanen, “Menage a trois? Jurisdiction, Admissibility and Competence in Investment Treaty Arbitration.”*ICSID Review: Foreign Investment Law Journal* Vol. 29 No. 1 (February 2014);
- Veijo Heiskanen, “Jurisdiction v Competence: Revisiting a Frequently Neglected Distinction. ”*The Finnish Yearbook of International Law* Volume V (1994);
- Vello Pettai, “Estonia’s constitutional Review mechanisms: a guarantor of democratic consolidation”. Në Vello Pettai and Jan Zielonka (eds.) *The Road to the European Union Vol. 2: Estonia, Latvia and Lithuania* (Manchester University Press: Manchester/New York, 2003);
- Victor F. Comella, “The European model of constitutional Review of legislation: Toward decentralization?”. *International Journal of Constitutional Law* Vol. 2 No. 3 (2004);
- Viktor Mavi, “Limitations of and Derogations from Human Rights in International Human Rights Instruments” *Acta Juridica Hungarica* Vol. 38 No. 3-4 (1997);
- Vincy Fon & Francesco Parisi, “Judicial precedents in civil law systems: A dynamic analysis”. *International Review of Law and Economics* Vol. 26 Issue 4 (2006);
- Visar Morina, “The Newly Established Constitutional Court in Post-Status Kosovo: Selected Institutional and Procedural Concerns”. *Review of Central and East European law Vol.* 35 Issue 2 (2010);
- Visar Morina, “The *Legal Prospective Force of Constitutional Courts Decisions: Reflections from the Constitutional Jurisprudence of Kosovo and Beyond” Nottingham Law Journal Vol.*

25 (2016);

- Visar Morina, Fisnik Korenica dhe Dren Doli, "The Relationship between International Law and National Law in the Case of Kosovo: A Constitutional Perspective" *International Journal of Constitutional Law* Vol. 9 No. 1 (2011);
- Vlad Perju, "The Romanian double executive and the 2012 constitutional crisis". *International Journal of Constitutional Law*, Volume 13, Issue 1, (January 2015);
- Vladislav B. Sotirovic: "The 1917 Corfus Declaration and its Importance for the Creation of the Kingdom of Serbs, Croats and Slovenes in 1918."*The South Slav Journal*, Vol. 33 No. 1−2 (London−Belgrade: Spring, 2014);
- Wayne S. Vucinich, Jozo Tomasevich, *Contemporary Yugoslavia: Twenty Years of Socialist Experiment* (University of California Press: Berkeley and Los Angeles, 1969);
- Wilhelm Karl Geck, "Judicial Review of Statutes. A Comparative Survey of Present Institutions and Practices"*Cornell Law Review* Vol. 51 Issue 2 (Winter, 1966);
- Willard A. Beling, "Some Implications of the New Constitutional Monarchy in Marocco". *Middle East Journal* Vol. 18, No. 2 (Spring, 1964);
- William C. Jones, "The Constitution of the People's Republic of China". *Washington University Law Review* Volume 63 Issue 4 (1985);
- William M. Landes and Richard A. Posner, "The Economics of Anticipatory Adjudication" *The Journal of Legal Studies.* Vol. 23, No. 2 (June, 1994);
- William Michael Reisman, "International Non-Liquet: Recrudescence and Transformation". *International Lawyer* Vol. 3 No. 4 (July, 1969);
- Willis B. Perkins, "The English Judicature Act of 1873". *Michigan Law Review* Vol. 12 No. 4 (February 1914);
- Wojciech Sadurski, "Constitutional Justice, East and West: An Introduction". Në Wojciech Sadurski (ed), *Constitutional Justice, East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective* (Kluwer Law International: The Hague, 2002);
- Wojciech Sadurski, *Rights Before Courts. A Study of Constitutional Courts in Postcommunist States of Central States of Central and Eastern Europe* (Springer: The Netherlands, 2008);
- Wolfgang Zeidler, "Federal Constitutional Court of the Federal Republic of Germany: Decisions on the Constitutionality of Legal Norms". *Notre Dame Law Review* Vol. 62 Issue 4 (1987);
- Xavier Aurey, Anne-Sophie Denolle, Marie Rota and Vincent Souty, "French Constitutional law Chronicle: January 2007 - March 2008*". Revus. Journal for Constitutional Theory and Philosophy of law/Revija za ustavno teorijo in filozofijo prava*. 7|2008 (Legitimnost ustavnosodnega odločanja);
- Xavier Groussot *&* Timo Minssen, "Res Judicata in the Court of Justice Case-Law: Balancing Legal Certainty with Legality?" *European Constitutional Law Review,* Vol. 3 Issue (November 2007);
- Yaniv Roznai, "The Theory and Practice of 'Supranational' Limits on Constitutional Amendments". *International and Comparative Law Quarterly.* Vol. 62 Issue 03 (July 2013);
- Yaniv Roznai, "Unconstitutional Constitutional Amendments - The Migration and Success of a Constitutional Idea". *The American Journal of Comparative Law.* Vol. 61, No. 3 (Summer 2013);
- Yasushi Hazama, "Hegemonic preservation or horizontal accountability: constitutional review in Turkey". *International Political Science Review* Vol. 33 No. 4 (2012);
- Yoav Dotan, "Judicial Review and Political Accountability: The Case of the High Court of Justice in Israel". *Israel Law Review* Volume 32, Issue 3 (Summer 1998);
- Yoram Rabin Arnon Gutfel, "*Marbury v. Madison* and Its Impact on Israeli Constitutional Law". *University of Miami International and Comparative Law Review Vol*. 15 No. 2 (2014);

- Yuhniëo Ngenge, "International Influences and the Design of Judicial Review Institutions in Francophone Africa" *American Journal of Comparative Law* Vol. 61 No. 2 (Spring 2013);
- Yves Haeck, Clara Burbano Herrera and Leo Zwaak, "Strasbourg's Interim Measures Under Fire: Does the Rising Number of State Incompliances with Interim Measures Pose a Threat to the European Court of Human Rights?" *European Yearbook on Human Rights*, Vol. 11 (March 1, 2011);
- *Zdeněk Kühn and* Jan Kysela, "Nomination of Constitutional Justices in Post-Communist Countries: Trial, Error, Conflict in the Czech Republic. *European Constitutional Law Review* Volume 2 Issue 02 (June 2006);
- *Zdeněk Kühn, "The Constitutional Court of the Czech Republic". Në* András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* (Cambridge University Press: Cambridge, 2017);
- Zdenk Kühn and Jan Kysela, "Nomination of Constitutional Justices in Post-Communist Countries: Trial, Error, Conflict in the Czech Republic". *European Constitutional Law Review* Volume 2 Issue 02 (June 2006);
- Zoila Combalia & Maria Roca, "Religion and the Secular State of Spain". Në Javier Martínez-Torrón and W. Cole Durham, Jr. (eds.), *Religion and the Secular State: Interim National Reports Issued for the Occasion of the XVIIIth International Congress of Comparative Law* (The International Center for Law and Religion Studies: USA, July 2010);
- Jan Zielonka and Alex Pravda, *Democratic Consolidation in Eastern Europe. Vol. 2. International and Transnational Factors* (Oxford University Press: Oxford, 2001);
- Daniel Smilow, "The Judiciary: The Last Dangerous Branch?". Në Michel Rosenfeld and Andras Sajo (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law* (Oxford University Press: Oxford, 2012);
- John E. Ferejohn, "Constitutional Review in the Global Context" *New York University Journal of Legislation & Public Policy* Vol. 6 Issue 1 (2002);
- Victor Ferreres Comella, "The European model of constitutional review of legislation: Toward decentralization". *International Journal of Constitutional Law* Vol. 2 No. 2 (2004);
- Schnutz Rudolf Durr, "Comparative Overview of European Systems of Constitutional Justice". *Vienna Journal on International Constitutional Law* Vol. 5 Issue 2 (2011);
- Jurgen C.A. de Poorter, "Constitutional Review in the Netherlands: A Joint Responsibility". *Utrecht Law Review* Vol. 9 No. 2 (March) 2013;
- Leonard F.M. Besselink, The Proliferation of Constitutional Law and Constitutional Adjudication, or How American Judicial Review Came to Europe After All". Utrecht Law Review Vol. 9 Issue 2 (March 2013);
- Sergio Diaz Ricci, "La giustizia costituzionale nelle Province dell'Argentina". Në Luca Mezzetti, *SISTEMI E MODELLI DI GIUSTIZIA COSTITUZIONALE* (CEDAM: Padova, 2011);
- Ruben Hernandez Valle, "La giustizia costituzionale in Costa Rica". Në Luca Mezzetti, *SISTEMI E MODELLI DI GIUSTIZIA COSTITUZIONALE* (CEDAM: Padova, 2011);
- Stephen Zamora, "Judicial Review in Latin America". *Southwestern Journal of Law and Trade in the Americas* Vol. 7 No. 2 (2000);
- Dale Beck Furnish, "Judicial Review in Mexico". *Southwestern Journal of Law and Trade in the Americas* Vol. 7 No. 2 (2000);
- Robert S. Barker, "Judicial review in Costa Rica: Evolution and recent Developments". *Southwestern Journal of Law and Trade in the Americas* Vol. 7 No. 2 (2000);
- Keith S. Rosen, "Judicial review in Brasil: Developments Under the 1988 Constitution". *Southwestern Journal of Law and Trade in the Americas* Vol. 7 No. 2 (2000);
- Mark Gould, "Islam, the Law, and the Sovereignty of God". Islam, the Law, and The Sovereignty of God" *Policy Review* No. 149 (June/July 2008);
- Nathan J. Brown, "Egypt: A Constitutional Court in an Unconstitutional Setting". A paper pre-

pared for the constitutional transitions and global and comparative law colloquium (New York University School of Law: 23 October 2013);
- Mark Gould, "Toward a Theory of Islamist Movements". *Sociology of Islam*, Volume 2, Issue 1-2 (2014);
- Tom Gerald Daly, "A CONSTITUTIONAL COURT FOR SRI LANKA? PERCEPTIONS, POTENTIAL & PITFALLS". *CPA Working Papers on Constitutional Reform* | No. 15, April 2017 | Në internet: Centre for Policy Alternatives | www.cpalanka.org (shikuar në korrik 2017);
- Hans-Georg Heinrich and Ludmilla Lobova (eds.), *Legal Systems in Transition: A Comparison of Seven Post-Soviet Countries* (Peter Lang GmbH: Frankfurt am Main, 2006);
- Tom Ginsburg, "Constitutional Courts in East Asia: Understanding Variation" *Journal of Comparative Law* Volume 3 Issue 2 (2008);
- Andreë Harding and Peter Leyland, "The Constitutional Courts of Thailand and Indonesia: Two Case Studies from South East Asia" *Journal of Comparative Law* Volume 3 Issue 2 (2008);
- Wen Chen Chang, "The Constitutional Court of Taiwan. "Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* (Cambridge University Press: Cambridge, 2017);
- Buquicchio, Gianni / Pierre Garrone, "L'harmonisation du droit constitutionnel européen: la contribution de la Commission européenne pour la démocratie par le droit". *UNIFORM LAW REVIEW/REVUE DE DROIT UNIFORME* Vol. III No. 2/3 (1998);
- Garrone, Pierre, "La commission de Venise à la veille de son 10e anniversaire". *Rivista di Studi politici internazionali*, 1999;
- Gianni Buquicchio/ Pierre Garrone, "Vers un espace constitutionnel commun - Le rôle de la Commission de Venise". Në *Bruno Haller et al*. (*ed*.), *Law* in *Greater Europe – Towards* a *Common Legal* Area- Studies in *Honor* of *Heinrich Klebes* (*Kluwer Law International*, The *Hague*, *2000*);
- Alain Chablais / Pierre Garrone, "European Commission for Democracy through Law - Review of Recent Reports and Opinions Relevant to the Protection of National Minorities" *European Yearbook of Minority Issues,* Vol. 05 (2005/6);
- Pieter van Dijk, "The Venice Commission on certain aspects of the European Convention of Human Rights". Në Stephan Breitenmoser et al. (eds.), *Human Rights, Democracy and the Rule of Law - Menschenrechte, Demokratie und Rechtsstaat – Droits de l'homme, démocratie et Etat de droit. Liber amicorum Luzius Wildhaber* (Dike Verlag: Zürich/St. Gallen, 2007);
- Amaya Ubeda de Torres, "*La régionalisation par la coordination interétatique: le rôle catalyseur de la Commission de Venise"*Në Stéphane Doubé-Billé (ed.), *La régionalisation du droit international. Cahiers de droit international* (Bruylant Edition: Bruxelles, 2012);
- Gianni Buquicchio/ Simona Granata-Menghini, "The Venice Commission Twenty Years on. Challenge met but Challenges ahead". Në Marjolein van Roosmalen/ Ben Vermeulen/ Fried van Hoof/ Merten Oostling (eds.), *Fundamental Rights and Principles – Liber Amicorum Pieter van Dijk* (Intersentia: Cambridge, Antwerp, Portland 2013);
- Wolfgang Hoffmann-Riem, "The Venice Commission of the Council of Europe – Standards and Impact". *The European Journal of International Law* Vol. 25 No. 2 (2014);
- Sergio Bartole, "International Constitutionalism and Conditionality - the Experience of the Venice Commission" *Rivista AIC - Associazione Italiana dei Costituzionalisti*, 4/2014;
- Maartje De Visser, "A Critical Assessment of the Role of the Venice Commission in Processes of Domestic Constitutional Reform" *American Journal of Comparative Law* Vol. 63 No. 4 (2015);
- Cesare Pinelli, "Parliaments, Constitutional Transitions and the Venice Commission". Report at the LUISS Summer School on "Parliamentary Democracy in Europe", LUISS, Rome, 23 July 2015;
- Sergio BARTOLE, "THE EXPERIENCE OF THE VENICE COMMISSION: SOURCES AND

MATERIALS OF ITS ELABORATION OF THE INTERNATIONAL CONSTITUTIONAL LAW". *THE EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION)*, Strasbourg, 14 December 2016 CDL-PI (2016) 016'

- Hanna SUCHOCKA, "CONSTITUTIONAL HERITAGE AND THE FORM OF GOVERNMENT". *THE EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION),* Strasbourg, 15 December 2016 CDL-PI(2016)017;
- Kaarlo Tuori, "From Copenhagen to Venice."Në Carlos Closa & Dimitry Kochenov (eds.) *Reinforcing Rule of Law Oversight in the European Union* (Cambridge University Press: Cambridge, 2016);
- Valentina Volpe, "Drafting Counter-majoritarian Democracy. The Venice Commission's Constitutional Assistance", *Heidelberg Journal for International Law, ZaöRV* Vol. 76 No. 4 (2016);
- Dimitrije Kulic, "The Constitutional Court of Yugoslavia in the Protection of Basic Human Rights" *Osgoode Hall Law Journal* Vol. 11 No. 2 (August 1973);
- Dimitrijue Kulic, "Constitutionality and Constitutional Justice."22 *Collection Papers Faculty of Law Nis* 45 (1982);
- Mato Arlović, "Međuodnos Ustavnog suda Republike Hrvatske i sudbene vlasti u Republici Hrvatskoj". *Zbornik radova Pravnog fakulteta u Splitu.* God. 52 Br. 2 (2015);
- Olivera Vucic & Dragan M. Stojanovic, "European Model of Constitutional Justice. Its Existence and Perspective". *Zbornik Radova Pravnog Fakulteta u Nisu*. Broj 69 Godina LIV (2015);
- David Deener, "Judicial Review in Modern Constitutional Systems"*American Political Science Review* Vol. 46 Issue 4 (1952);
- Bruce Ackerman, "The Rise of World Constitutionalism" *Virginia Law Review* Vol. 83 No. 4 (May, 1997);
- Yuval Shany, How Supreme is the Supreme Law of the Land? Comparative Analysis of the Influence of International Human Rights Treaties Upon the Interpretation of Constitutional Texts by Domestic Courts. *Brooklyn Journal of International Law* Vol. 31 No. 2 (2006);
- Andreas Voßkuhle, "Multilevel Cooperation of the European Constitutional Courts. *Der Europäische Verfassungsgerichtsverbund.*" *European Constitutional Law Review* Vol. 6 (October, 2010);
- Mauro Capelleti, "Necessite e legitimite de la justice constitutionelle". *Revue internationale de droit compare* Vol. 33 No. 2 (Avril-juin 1981);
- Theodore Holo, "Emergence de la justice constitutionelle". *Pouvoirs* Vol. 2 No. 129 (2009);
- Visar Morina, "The Newly Established Constitutional Court in Post-Status Kosovo: Selected Institutional and Procedural Concerns". *Review of Central and East European Law* Vol. 35 Issue 2 (2010);
- Visar Morina, Fisnik Korenica and Dren Doli, "The relationship between international law and national law in the case of Kosovo: A constitutional perspective". *International Journal of Constitutional Law* Vol. 9 No. 1 (2011);
- Visar Morina, "The Legal Prospective Force of Constitutional Courts Decisions: Reflections from the Constitutional Jurisprudence of Kosovo and Beyond". *Nottingham Law Journal* Vol. 25 (2016);
- Thomas Healy, "Stare Decisis as a Constitutional Requirement". *West Virginia Law Review* Vol. 104 Issue 1 (2001);
- Karen Reid, *A Practitioner's Guide to the European Convention on Human Rights*. Second Edition (Sweet Maxwell Ltd.: London, 2004);
- Daniel A. Farber, "The Rule of Law and the Law of Precedents" Minnesota Law Review Vol. 90 (2005-2006);
- Thomas Healy, "Stare Decisis and the Constitution: Four Questions and Answers". Notre Dame Law Review Vol. 83 Issue 3 (2008).

C. AKTE JURIDIKE:

- *Act CLI of 2011 on the Constitutional Court* [Hungary], 2011. Në internet: https://www.refworld.org/docid/ 4 c 3 45b5b2. html (shikuar më 29 korrik 2019);
- Act CLI of 2011 on the Constitutional Court. Në internet: https://hunconcourt.hu/rules/act-on-the-cc (shikuar së fundi në maj 2019);
- Act n. CLI. of 2011 on the Constitutional Court. 22 May 2017. Në internet: https://hunconcourt.hu/act-on-the-cc/ (shikuar në korrik 2019);
- *Act on the Federal Constitutional Court* (Bundesverfassungsgerichtsgesetz-BVerfGG). Date of signature:12 March 1951. Në internet: http://www.bundesverfassungsgericht.de /Shared-Docs/Downloads/EN/Gesetze/BVerfGG.pdf?blob=publication File&v=6 (shikuar më 31 korrik 2019);
- AFFAIRE HORNSBY c. GRÈCE CASE OF HORNSBY v. GREECE (ARTICLE 50) (107/1995/613/701) ARRÊT/JUDGMENT Strasbourg. 1 er avril/ 1 April 1998. Në internet: https://www.legal-tools.Org/doc/e 571e8/pdf/ (shikuar më 6 korrik 2019);
- Akdivar and Others v. Turkey. ECtHR, Judgment of 16 September 1996, Reports of Judgments and Decisions 1996-IV;
- *Aktgjykimi i 1 korrikut 2014 në rastin nr. KO 103/14* (Parashtrues: Presidentja e Republikës së Kosovës. Përkitazi me vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 84 (14) [Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës);
- *Aktgjykimi i 20 shtatorit 2012 në rastin nr. K0 57/12* (Kërkesa e Presidentes së Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së Saj, Atifete Jahjaga, me të cilën konteston votimin për miratimin e Ligjit nr. 04/1-084 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë të Kosovës);
- *Aktgjykimi i 22 dhjetorit 2010 në rastin nr. KO 97/10* (Kërkesa e parashtruar nga Ushtruesi i Detyrës së Presidentit, z. Jakup Krasniqi, lidhur me mbajtjen e postit të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit dhe njëkohësisht të postit të Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Demokratike të Kosovës);
- *Aktgjykimi i 23 dhjetorit 2015 në rastin nr. KO 130/15* (Parashtrues: Presidentja e Republikës së Kosovës. Lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar "*Asociacioni/Bashkësia i komunave* me *shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore"* me frymën e Kushtetutës, me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës);
- *Aktgjykimi i 7 tetorit 2010 në rastin nr. KO 80/10* (Kërkesa e Presidentit të Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së Tij, dr. Fatmir Sejdiu, për sqarim të kompetencave në rastin e kryetarit të Rahovecit, z. Qazim Qeska);
- *Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës AA Uzh nr.20/2019 i datës 30.10.2019* (Aktgjykimi i GJSK);
- *Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtruesi: Agron Xhaferi. Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 15/2003 të 30 qershorit 2004;*
- *Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtruesi: Bekim Murati. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Kosovës (11/279), të 07.11.2007;*
- *Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtruesi: Lumnije Krasniqi. Vlerësim i kushtetutshmërisë* së Vendimit të Komisionit të Kërkesave Banesore dhe Pronësore HPCC/D/144/2004/C, të datës 27 gusht 2004;
- *Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Astrit Shabani. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pn-Kr 56/2006, Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Ap. nr. 52/2004 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. nr. 94/01;*
- *Aktvendim për Papranueshmëri .Parashtrues: Maria Strugari. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, GJL. nr. 1288/2011, të 28 tetorit 2011*. Nr. ref.: RK215/12;
- *Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Sabile Sopjani. Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 601/02, të 15 shtatorit 2004*;

- Amendamentet XVIII-LV në Kushtetutën e KSAK. *Gazeta Zyrtare e KSAK* nr. 24. Prishtinë, 10 korrik 1989;
- Amuur v. France, 17/1995/523/609, Judgement, Chamber, ECtHR, 25 June 1996;
- *Article 1 of the Protocol No. 15 amending the Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms.* Council of Europe Treaty Series No. 213. Në internet: https:// www.coe.int/en/web/conventions/full-list/ /conventions/rms/0900001680084831(shikuar në janar 2020);
- Basic Law for the Federal Republic of Germany, 23 May 1949. Last amended on 13 July 2017. Në internet: https://www.btg-bestellservice.de/pdf/80201000.pdf (shikuar në korrik 2019);
- *Basic Law: Freedom of Occupation* (1994);
- *Basic Law: Human Dignity and Liberty* (1992). (Unofficial translation by Dr. Susan Hattis Rolef);
- *BASIC LAW: THE JUDICIARY* (5748 - 1984);
- *Basic Law: the Knesset* (1958);
- CASE OF BURDOV v. RUSSIA. *(Application no. 59498/00).* JUDGMENT. Strasbourg. 7 May 2002. Në internet: http://sutyajnik.ru/rus/echr/judgments/burdov.htm (shikuar më 6 korrik 2019);
- COMMISSION EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME / EUROPEAN COMMISION OF HUMAN RIGHTS. *DÉCISION SUR LA* RECEVABILITÉ. Application No. 23727/94 by *Gerhard OBERSCHLICK against Austria.* The Facts. Në internet: https://www.menschen-rechte.ac.at/orig/ 954/ Oberschlickcv% 20AZE.pdf shikuar në dhjetor 2020);
- *Constitución de 1851 (25 de febrero de 1851) ;*
- *Constitucion Politica de Bolivia de 1967 con reformas de 1994*;
- *Constitutcion Politica de la Republica Peruana (1823)*;
- Constitution of Colombia of 1991 with Amendments through 2005;
- *Constitution of Chile of 1980 with Amendments through 2012;*
- *CONSTITUTION DE LA REPUBLIQUE ALGERIENNE DEMOCRATIQUE ET POPULAIRE*. Në internet: http:// publicofficialsfinancialdisclosure.worldbank.org/sites/fdl/files/assets/law-library-files/Algeria_Constitution_1963 % 20amended%202008_fr.pdf (shikuar në korrik 2017);
- *CONSTITUTION DE LA REPUBLIQUE ALGERIENNE DEMOCRATIQUE ET POPULAIRE*. Në internet: http:// publicofficialsfinancialdisclosure.worldbank.org/sites/fdl/files/assets/law-library-files/Algeria_Constitution_1963 % 20amended%202008_fr.pdf (shikuar në korrik 2017);
- Constitution of Algeria of 10 September 1963. Në internet: http://mjp.univ-perp.fr/constit/ dz1963 htm#7 (shikuar në korrik 2017);
- *Constitution of Argentina of 1853, Reinstated in 1983, with Amendments through 1994*;
- Constitution of Azerbaijan of 1995 with Amendments through 2009;
- *Constitution of Brasil of 1988 with Amendments through 2014;*
- *Constitution of Costa Rica of 1949 with Amendments through 2011*;
- Constitution of Cuba of 1976 with Amendments through 2002;
- *Constitution of Egypt of 2014.* Në internet: https://www. constituteproject. org/ constitution / Egypt 2014.pdf (shikuar në korrik 2017);
- *Constitution of Honduras of 1982 with Amendments through 2013;*
- *Constitution of Japan of 1946*;
- *Constitution of Kyrgyzstan of 2010*;
- *Constitution of Malaysia of 1957 with Amendments through 2007*;
- *Constitution of Mongolia of 1992 with Amendments through 2001*;
- *Constitution of Morocco of 2011.* Në internet: https://www. constituteproject. org/constitution/ Morocco_ 2011. pdf?lang=en (shikuar në korrik 2017);
- Constitution of Nicaragua of 1987 with Amendments through 2005;
- Constitution of Nicaragua of 1987 with Amendments through 2014;
- *Constitution of Panama of 1972 with Amendments through 2004;*
- *Constitution of Paraguay of 1992 with Amendments through 2011*;
- *Constitution of Plurinational State of Bolivia of 2009*;

- *Constitution of Saudi Arabia of 1992 with Amendments through 2005*. Në internet https://www. Constituteproject. org/constitution/Saudi_Arabia_2005.pdf (shikuar në korrik 2017);
- *Constitution of Singapore of 1965, with amendments through 1995*;
- Constitution of Suriname of 1987 with Amendments through 1992;
- *Constitution of Taiwan of 1946 with Amendments through 2005*;
- *Constitution of Tajikistan of 1994 with Amendments through 2003;*
- *CONSTITUTION OF THE CO-OPERATIVE REPUBLIC OF GUYANA. ACT 1980*;
- *Constitution of the Islamic Republic of Pakistan* (As modified up to the 28th February, 2012). Në internet: http://na.gov.pk/uploads/documents/1333523 681_951.pdf (shikuar në korrik 2017);
- *CONSTITUTION OF THE ISLAMIC REPUBLIC OF PAKISTAN, 1973. As Amended by The Constitution Twenty Third Amendment Act, 2017*;
- *Constitution of the people's Republic of China of 1982 through Amendments 2004;*
- Constitution of the Principality of Liechtenstein of 5 October 1921. As of: 1 February 2014;
- *Constitution of the Republic of Korea 1948 with Amendments through 1987;*
- *Constitution of the Republic of Paraguay of 1967;*
- *Constitution of the Republic of South Africa Act 200 of 1993. Repealed by the Constitution of the Republic of South Africa, [No. 108 of 1996], G 17678, 18 December 1996*;
- *Constitution of the Republic of Turkey* (1982);
- Constitution of Turkey of 1982 with Amendments through 2017. https://global. tbmm. gov. tr / docs/constitution_en.pdf (shikuar në prill 2018);
- *Constitution of Uruguay of 1966, Reinstated in 1985, with Amendments through 2004*;
- *Constitution of Uzbekistan of 1992 with Amendments through 2011;*
- *Constitutional Court Act of 16 June 1993 as amended by Acts No. 331/1993 Sb., 236/1995 Sb., 77/1998 Sb., 18/2000 Sb., 132/2000 Sb., 48/2002 Sb., 202/2002 Sb., 320/2002 Sb., 114/2003 Sb., 83/2004 Sb., 120/2004 Sb., 234/2006 Sb., 342/2006 Sb., 227/2009 Sb. 404/2012 Sb., and 275/2012 Sb.:* Në internet: https://www.usoud.cz/fileadmin/user_upload/ustavni_ soud www/ Pravni _ uprava /AJ/ Constitutional court act1821993.pdf (shikuar më 3 korrik 2019);
- *CONSTITUTIONAL COURT ACT*, Act No. 4017, Aug. 5, 1988;
- *Constitutional Court Complementary Act 13 of 1995*;
- Constitutional Court Judgment No. 198/2012 of November 6 (Unofficial translation). Në internet: https://www.tribunalconstitucional.es/ResolucionesTraducidas/ 198-2012%20of%20 November%206.pdf;
- Constitutional Court Judgment No. 31/2010, of June 28 (Unofficial translation). Constitutional Tribunal of Spain. Në internet: https://www.tribunalconstitucional.es/ResolucionesTraducidas/31-2010,%20of%20June% 2028.pdf (shikuar në 26 qershor 2019);
- Constitutional Court Judgment No. 5/1981, of February 13. Constitutional Tribunal of Spain (Unofficial translation). Në internet: https://www.tribunalconstitucional.es/ResolucionesTraducidas/5-1981,%20of%20Februar y%2013.pdf;
- Constitutional Court Judgment No. 53/1985, of April 11 1985. Constitutional Tribunal of Spain (Unofficial translation). Në internet: https://www.tribunalconstitucional.es/ResolucionesTraducidas/53-1985,%20of%20 April %2011.pdf (shikuar më 25 qershor 2019);
- *Constitutional Interpretation Procedure Act of 3 February 1993*;
- COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME / EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS QUATRIEME SECTION AFFAIRE ZAWADZKI c. POLOGNE *(Requête n° 34158/96)*ARRÊT STRASBOURG 20 décembre 2001DÉFINITIF 27/03/2002. N*ë* internet: https://sip.lex.pl/ orzeczenia-i-pisma-urz edowe/orzeczenia-sadow/34158-96-zawadzki-v-polska-wyrok-europ ejskiego-520957187 (shikuar në janar 2020);
- COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME / EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS. *QUATRIÈME SECTION. DÉCISION PARTIELLE SUR LA RECEVABILITÉ de la requête n° 34158/96 présentée par Józef ZAWADZKI contre la Pologne.* Në internet: https:// sip.lex.pl/orzeczenia-i-pisma-urzedowe/orzeczenia-sadow/ 34158-96-zawadzki-v-polska-decyzja-europejskiego-520619086 (shikuar në janar 2020);
- COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME / EUROPEAN COURT OF HUMAN

RIGHTS. FOURTH SECTION DECISION AS TO THE ADMISSIBILITY OF. *Application no. 8559/08 by James DOWSETT (No. 2) against the United Kingdom*;

- COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS. *DÉCISION SUR LA RECEVABILITÉ de la requête n° 36445/97 présentée par Emile SABLON contre la Belgique*. Në internet: https://sip.lex.pl/orzeczenia-i-pisma-urzedowe/orzeczenia-sadow/36445-97-sablon-v-belgia-decyzja-europe jskiego-520618741 (shikuar në janar 2020);
- COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS. *TROISIÈME SECTION AFFAIRE SABLON c. BELGIQUE (Requête n° 36445/97). ARRÊT STRASBOURG 10 avril 2001. DÉFINITIF. 05/09/2001*. Në internet: https://www.doctrine.fr/d/CEDH/HFJUD/CHAMBER / 2001/CEDH001-63932 (shikuar në janar 2020);
- COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS. *CASE OF ASSANIDZE v. GEORGIA (Application no. 71503/01). JUDGMENT*. STRASBOURG 8 April 2004;
- COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS. FIRST SECTION DECISION Application no. 24912/08. *Johann NISTLER against Austria*. Në internet: https://sip.lex.pl/orzeczenia-i-pisma-urzedowe/orzeczenia-sadow/24912-08-nistler-v-austria-decyzja-europejskiego521 490408 (shikuar në janar 2020);
- COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS. CASE OF DICHEV v. BULGARIA *(Application no. 1355/04)* JUDGMENT. STRASBOURG 27 January 2011;
- Czech Republic's Constitution of 1993 with Amendments through 2002. Në internet: https://www.constituteproject.org/constitution/Czech_Republic_2002.pdf (shikuar në korrik 2019);
- D. H. et al. v. The Czech Republic, Application no. 57325/00, Judgement, Grand Chamber, ECtHR, 13 November 2007, para. 116 (referring to İlhan v. Turkey [GC], no. 22277/93, para. 59, 2000-VII);
- ECtHR, Azinas kundër Qipros, nr. *56679/00,* vendim i datës 28 prill 2004;
- ECtHR. Case of Mamatkulov and Askarov v. Turkey (Applications nos. 46827/99 and 46951/99). Judgement. Strasbourg. 4 February 2005. Paras. 108 & 113;
- ECtHR: Banković and others v. Belgium and others.(Application no. 52297/99, § 60, Judgement of 12 December 2001);
- ECtHR: Hirst v. the United Kingdom (Application no. 74025/01, Judgement of 6 October 2006);
- Eisenberg v. Minister of Building and Housing. HCJ 6163/92. Decided: March 23, 1993. Në internet: https://versa.cardozo.yu.edu/opinions /eisenberg-v-minister-building-and-housing;
- European Convention on Human Rights. Rome: 4. XI. 1959 (with its Protocols, 1, 4, 6, 7, 11, 12, 13, 14 and 16)". Në internet: https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_ENG.pdf (shikuar në janar 2020);
- Evans v. Gore, 253 U.S. 245 (1920). U. S. Supreme Court. Në internet: https://supreme.justia.com/cases/ federal/us/253/245/ (shikuar në prill 2018);
- *Federal Constitutional Court Act* in the version of 11 August 1993 (Federal Law Gazette I p. 1473), last amended by Article 1 of the Act of 18 July 2017 (Federal Law Gazette I p. 2730). Në internet: http://www. bundesverfassungsgericht. de/SharedDocs/ Downloads/ EN/Gesetze/ BVerfGG. pdf?blob=publicationFile&v=5 (shikuar në mars 2018);
- *Federal Constitutional Court Act in the version of 11 August 1993 (Federal Law Gazette I p. 1473), last amended by Article 2 of the Act of 8 October 2017* (Federal Law Gazette I p. 3546). Në internet: http://www.bundesverfassungsgericht. de/SharedDocs/Downloads/EN/Gesetze/BVerfGG.pdf?__blob=publicationFile&v=6 (shikuar më 26 korrik 2019);
- France's Constitution of 1958 with Amendments through 2008. Në internet: https://www.constitute project.org/constitution/France_2008.pdf?lang=en (shikuar në korrik 2019);
- GJEDNJ, Assenov and Others v. Bulgaria, §102);
- GJEDNJ, Azinas kundër Qipros, Nr. 56679/00, Vendim i 28 prillit 2004);
- GJEDNJ, McCann and Others v. the United Kingdom, § 161;

- GJEDNJ, Osman v. the United Kingdom, §§ 115-117 dhe Rees v. the United Kingdom, § 37;
- GJEDNJ, Osman v. the United Kingdom, §§ 115-117;
- GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, Nr. 25803/94, Vendim i 28 korrikut 1999);
- Grand Chamber. ECtHR Case of Micallef v. Malta (Application no. 17056/06) Judgement. Strasbourg, 15 October 2009;
- Honduras's Constitution of 1982 with Amendments through 2012;
- Hungary's Constitution of 2011. Në internet: https://www.constituteproject.org/constitution/Hungary_2011.pdf (shikuar në korrik 2019);
- International Covenant on Civil and Political Rights. Adopted by the General Assembly of the United Nations on 19 December 1966. *United Nations. Treaty Series*, vol. 999 and vol. 1057, p. 407. Në internet. https://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=IV-4&chapter= 4 & lang=en (shikuar në janar 2018);
- Israel: Basic Law of 1992, Human Dignity and Liberty, 25 March 1992. Në internet: https://www.refworld. org/docid/3ae6b52618.html (shikuar më19 qershor 2019);
- Israel: Basic Law of 1994, Freedom of Occuptaion, 9 March 1994. Në internet: http://www.servat.unibe.ch/icl/is11000_.html;
- *JAMAICA (CONSTITUTION) ORDER IN COUNCIL. 1962*;
- Judgement: Case 36/2000 (X.27) AB. Constitutional Court of Hungary. Në internet: https://www.globalhealthrights.org/health-topics/health-care-and-healthservices/decision-362000-x-27-ab/ (shikuar në qershor 2019);
- *Judgment No. 21 – P/2015of 14 July 2015 of the Constitutional Court of the Russian Federation Circulated as a document of the Venice Commission CDL-REF (2016) 019. Strasbourg, 23 February 2016 (Opinion No. 832/2015);*
- КОНСТИТУЦИОННЫЙ ЗАКОН РЕСПУБЛИКИ ТАДЖИКИСТАН О КОНСТИТУЦИОННОМ СУДЕ РЕСПУБЛИКИ ТАДЖИКИСТАН (Ведомости Маджлиси Оли Республики Таджикистан 1995;
- *KI 99/14 & KI 100/14. Aktgjykim. Parashtrues: Shyqyri Syla dhe Laura Pula. Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me procedurën e zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit.* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, 8 korrik 2014 Nr.ref.: AGJ679/14;
- Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale (*Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*. Nr. 37, 28 dhjetor 2012);
- Kushtetuta e Austrisë e vitit 1920, në fuqi me ndryshimet dhe plotësimet e mëpastajme. Në internet: http://constitutionnet.org/sites/default/files/Austria%20_FULL_%20Constit ution.pdf (shikuar më 8 korrik 2019);
- Kushtetuta e Kaçanikut, 7 shtator 1990;
- Kushtetuta e KSA të Kosovës. *Gazeta Zyrtare e KSAK* nr. 4. Prishtinë, 27 shkurt 1974;
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Aneks: Amendamentet I – XXII Amendamentimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare te pavarësisë së Kosovës. *Vendimi i Kuvendit të Republikës* së Kosovës, nr. 04- V- 436 të datës 7 shtator 2012. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* nr. 25 datë 7 shtator 2012;
- *LAW NUMBER 24 OF YEAR 2003 ON THE CONSTITUTIONAL COURT OF THE REPUBLIC OF INDONEZIA.* (August 2003);
- *Law of the Republic of Uzbekistan of May 31, 2017 No. ZRU – 431 About the Constitutional Court of the Republic of Uzbekistan*. (accepted by Legislative House on May 23, 2017 and approved by the Senate on May 27, 2017);
- *Law on Constitutional Court (Tsets) of Mongolia of 1992*;
- *LAW ON THE ESTABLISHMENT AND RULES OF PROCEDURE OF THE CONSTITUTIONAL COURT OF TURKEY* (LAW NO: 6216, ADOPTED 30 MARCH 2011);
- *Ley del Organo Judicial, Ley 025. 24 de Junio, 2010*;
- *Ley del Tribunal Constitucional Plurinacional, Ley no. 027. 6 de Julio, 2010*;
- *Ley del Tribunal Constitucional, Ley no. 1836. 1 de Abril, 1998*;
- Ley No. 260 "Ley Orgánica del Poder Judicial de la República de Nicaragua", publicada en La

Gaceta, Diario Oficial, No.137 del 23 dé julio de 1998;
- Ligji nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (me ndryshimet dhe plotësimet e tij të kryera me Ligjin nr. 03/L-256) *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* 31/2008 datës 15 qershor 2008 (LZP);
- *Ligji CLI i Hungarisë i vitit 2011 mbi Gjykatën Kushtetuese*. Në internet: https://www.refworld.org/docid/4c345b5b2.html, shikuar më 6 korrik 2019);
- *Ligji mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës Federale të Gjermanisë i vitit 1951*. Në internet: http://www.bundesverfassungsgericht.de/Shared Docs/Downloads/EN/Gesetze/BVerfGG.pdf?blob=publication File &v=6, shikuar më 6 korrik 2019);
- *Ligji mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Latvisë*. Në internet: http://www.satv.tiesa.gov.lv/en/, shikuar më 6 korrik 2019;
- Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (*Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.* Nr. 38, 20 shtator 2008, me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme);
- Ligji Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
- Ligji nr. 03/L-199 për Gjykatat i datës 24 gusht 2010 (me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme deri në vitin 2015);
- Ligji nr. 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-073 për Zgjedhjet e Përkohshme ne Republikën e Kosovës. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* nr. 87, datë 16 nëntor 2010;
- Ligji nr. 04/L-274 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë;
- *Ligji Nr. 8577, datë 10 shkurt 2000 mbi Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese* të Republikës së Shqipërisë, (ndryshuar me ligjin nr.99/2016). Në internet: http://www.gjk.gov.al/web/ligj_ per_organizimin_dhe_funksionimin_e_gjykates_ kushtetuese_ 2016_ 1667.pdf, (shikuar më 6 korrik 2019);
- Ligji nr. 8577, datë 10. 2. 2000 (ndryshuar me ligjin nr.99/2016) për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Në internet: http://www.gjk.gov.al/web/ligjperorganizimindhefunksioniminegjykateskushtetuese 2016 1667.pdf (shikuar në prill 2018);
- Ligji për Gjykatën Federale Kushtetuese të Gjermanisë, *BVerfGG,* i 12 marsit 1951;
- Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kroacisë. Në internet: https://www.usud.hr/sites/default/files/ dokumenti /The _ ConstitutionalAct_on_the_Constitutional_Court_of_the_Republic_of_Croatia_consolidated_text_Official_Gazette_No_49-02.pdf;
- Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Çekisë. Në internet: http://www.parliament.am/ library/sahmanadrakan%20 dataranner.nor/ch exia.pdf (shikuar në korrik 2019);
- Ligji nr 04/L-199 për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë;
- Ligji Nr. 05/L -053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, datë 3 gusht 2015;
- Ligji mbi Gjykatën Kushtetuese të Austrisë i vitit 1953 (me amendamentet e vitit 2016);
- Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën e Përgjithshme Kontestimore. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* / Prishtinë: Viti III / Nr. 38 / 20 shtator 2008;
- Ligji Nr. 03/L-04 për Vetëqeverisjen Lokale, i 20 shkurtit 2008. *Gazeta Zyrtare e Republikës* së Kosovës nr. 28, datë 4 qershor 2008;
- Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* / Nr. 20 / 21 qershor 2016, Prishtinë;
- Ligji Nr. 05/L-102 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Sundimit të Ligjit në Kosovë të datës 17 qershor 2016;
- Marrëveshja e Përkohshme ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Holandës mbi Organizimin e Institucionit të Gjykatës Speciale të Kosovës i Zhvendosur në Holandë, e lidhur në Prishtinë, më 26 janar 2016. Kjo marrëveshje është ratifikuar me *Dekretin DMN- 003-2016 të Presidentes së Republikës së Kosovës për Ratifikim të Marrëveshjes Ndërkombëtare*, i cili

mban datën 3 shkurt 2016;
- Marrëveshja për Telekomunikacionin në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, aprovuar me Vendimin e Qeverisë nr. 03/148;
- *Mexico's Constitution of 1917 with Amendments through 2015;*
- *Organic Law 2/1979 on the Constitutional Court, of 3 October 1979, as amended by the Organic Laws 8/1984, December 26th; 4/1985, June 7th; 7/1988, June 9th; 7/1999, April 21st; 1/2000, January 1st; 6/2007, May 24th; 1/2010, February 19th; 8/2010, November 4th; 12/2015, September 22nd and 15/2015, October 16th*. Në internet: https://www.tribunalconstitucional. es/ es/ tribunal/ normativa/ Normativa/LOTC-en.pdf (shikuar më 31 korrik 2019);
- Organic Law 6/1985, of 1 July, on the Judiciary. Published in the *Official State Gazette* nº. 157, of 2 July 1985, together with the subsequent modifications up until May 2007. Në internet: https://www.legal-tools.Org /doc/881df4/pdf/ (shikuar në korrik 2019);
- Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN), Vendimi Nr. 2009/09, Vendimi Nr. 2009/10 dhe Vendimi Nr. 2009/11;
- *Political constitution of the Republic of Chile: promulgated May 25, 1833, with the amendments down to May 1, 1899;*
- Protocol No. 1 to the Convention on the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms. *Council of Europe Treaty Series - No. 214*. Në internet: http://www.echr.coe.int/Documents/ Protocol _ 16ENG.pdf (shikuar në janar 2018);
- *Rastet K0 45/12 dhe K0 46/12. Aktgjykim. Kërkesa e Liburn Aliut dhe 11 deputetëve të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vlerësim të kushtetutshmërisë* së Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe dhe të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, më 25 qershor 2012. Nr.Ref.:AGJ 255/12;
- *Rastet e bashkuara KI 48/14 dhe KI 49/14. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Komuna e Vushtrrisë. Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktvendimeve të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri: (1) CPonr. 46/14, të 6 marsit 2014, (2) CPonr. 49/14, të 6 marsit 2014, (3) CPonr. 53/14, të 6 marsit 2014, (4) CPonr. 52/14, të 11marsit 2014, (5) CPonr. 54/14, të 11 marsit 2014 dhe të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1369/14, të 27 qershorit 2014*;
- *Rastet KI 176/18, KI 183/18 dhe KI 06/19. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Zeqir Demaku, Jahir Demaku, Fadil Demaku, Nexhat Demaku, Isni Thaçi, Bashkim Demaj, Selman Demaj, Driton Demaj dhe Agim Demaj. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme te Kosovës, Pml. nr. 158/2018, te 26 shtatorit 2018.* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, me 2 dhjetor 2019. Nr. ref.: RK 1471/19;
- *Rastet KI 199/14 dhe KI 100/14. Aktgjykim. Parashtrues: Shyqyri Syla dhe Laura Pula. Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me procedurën e zgjedhjes se Kryeprokurorit te Shtetit*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Nr. ref.: A GJ 679/14. Prishtinë, 8 korrik 2014;
- *Rastet KI 80/15, KI 81/15 dhe KI 82/15 (të bashkuara). Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Rrahim Hoxha. Vlerësim i kushtetutshmërisë* së aktvendimeve të Gjykatës së Apelit Ae. nr. 188/2014, 189/2014, të 19janarit 2015, dhe Aktvendimin Ae. nr. 190/2014, të 20 janarit 2015. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë: 27 dhjetor 2016. Nr. ref.:1028/16;
- *Rastet KO 29/12 & KO 48/12. Aktgjykim. Parashtrues: Kryetari i Kuvendit të Kosovës. Amendamentet e propozuara kushtetuese të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012.* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, më 20 korrik 2012. Nr. Ref.:AGJ 284/12;
- *Rastet nr. KI 146/17, KI 147/17, KI 148/17, KI 149/17 dhe KI 150/17. Aktgjykim. Parashtrues: Isni Thaçi, Zeqir Demaku, Fadil Demaku, Nexhat Demaku, dhe Jahir Demaku. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. KZZ. nr. 322/2016, te 19 korrikut 2017*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, më 7 Qershor 2018. Nr. Ref.: AGJ 1248/18;
- *Rasti K0 26/15. Vlerësim i amendamentit të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, të propozuar*

nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe referuar më 9 mars 2015 nga Kryetari i Kuvendit te Republikës së Kosovës, me Shkresën nr. 05-433jDO-318. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, më 15prill 2015. Nr. ref.: AGJ 788/15;

- *Rasti K0 38/12. Aktgjykim. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Propozimeve të Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës, të dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës më 12 prill 2012*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, më 15 maj 2012. Nr. ref.:AK 234 /12;
- *Rasti K0 79/18. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Presidenti i Republikës së Kosovs. Kërkesë për interpretim të nenin 139. paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, 3 dhjetor 2018 Nr. ref.: RK 1294/ 18;
- *Rasti K0 98/11. Aktgjykim. Parashtrues: Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës.* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Nr. ref.: AGJ 138/11. Prishtinë më 20 shtator 2011;
- *Rasti KI 78/12. Aktgjykim. Parashtrues: Bajrush Xhemajli, Vlerësim i kushtetutshmërisë* së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. Nr. 70/2012, të 22 qershorit 2012;
- *Rasti KO 120/16. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Slavko Simić dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, 1 shkurt 2017. Nr. ref.: RK1034/17;
- Rasti BVerfG 39, 169 (1975);
- Rasti BVerfG 4, 157 Saarstatut (1955);
- *Rasti C.nr.1209/13. Dokumenti nr. 00487072. Datë: 02.09.2019. Aktgjykim. Gjykata Themelore në Prishtinë*. Republika e Kosovës;
- *R*asti *De Cubber kundër Belgjikës,* Kërkesa nr. 9186/80, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 tetorit 1984;
- Rasti i distrikteve elektorale II, BVerfG 16, 130 (1963);
- Rasti i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Çeke në Zdeněk Kühn, "The Constitutional Court of the Czech Republic". Në Andras Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*;
- *Rasti K0 103/14. Aktgjykim. Parashtrues: Presidentja e Republikës* së Kosovës përkitazi me vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 84 (14) [Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverise] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Nr. ref.: AGJ 671/14. Prishtinë, më 1 korrik 2014;
- *Rasti K0 12/18. Aktgjykim. Parashtrues: Albulena Haxhiu dhe 30 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës Vlerësimi i kushtetutshmërisë* së Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 04/20, te 20 dhjetorit 2017. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë. Datë: 11 qershor 2018 Nr. ref.: AGJ 1258/18;
- *Rasti K0 126/16. Gjykata referuese: Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për* çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. OS/L-120 për *Trepçën*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtine, me 30 maj 2017. Nr. ref.: RK 1086/17;
- *Rasti K0 157/18. Aktgjykim. Parashtrues: Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 14, paragrafit 1.7 të Ligjit nr. 03/L- 179 për Kryqin e Kuq të Republikës se Kosovës*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, më 28 mars 2019. Nr. ref.: AGJ 1341/19;
- *Rasti K0 22/15. Vendim. Parashtrues: Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës. Kërkesë për përjashtim të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Nr. ref.: V 791/15. Prishtinë, më 17 prill 2015;
- *Rasti K0 26/15. Aktgjykim. Vlerësim i amendamentit të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe referuar me 9 mars 2015 nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, me Shkresën nr. 05-433jDO-318.* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Nr. ref.: AGJ 788/15. Prishtinë, me 15 prill 2015;
- *Rasti K0 44/14. Aktgjykim. Vlerësimi i amendamenteve të Kushtetutës të propozuara nga*

Qeveria, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 11mars 2014, me shkresën Nr. 04-DO-2186. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, më 3 prill 2014. Nr.ref.:AGJS98/14;

- *Rasti K0 47/16. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Aida Derguti, Bali Muharremaj, Enver Hoti dhe 25 deputetë te tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr, 05-V-233, të 26 shkurtit 2016, për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Nr. ref.: RK 911/ 16. Prishtinë, më 4 prill 2016;
- *Rasti K0 61/12. Aktgjykim. Konfirmimi i amendamenteve të propozuara kushtetuese, të paraqitura nga Kryetari i Kuvendit të Republikës* së Kosovës, më 22 qershor 2012, me shkresën Nr. 04-DO-1095. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, më 31 tetor 2012. Nr. ref.: AGJ303/12;
- *Rasti KI 02/09. Vendim për Papranueshmëri. Parashtruesi i kërkesës. Kolë Krasniqi nga Gjakova. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të Ministrisë së Bujqësisë nr. 2324 të datës 22 shtator 2009 dhe vendimit të Drejtorisë së* Çështjeve *Pronësore-Juridike dhe Rregullimin e Tokës* të Komunës së Gjakovës nr. *9-463-8/91-08 të datës 20 nëntor 2008*;
- *Rasti KI 02/11. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Esat Kurtaliqi. Vleresim i kushtetutshmërisë* së Vendimit të Gjykatës Komunale të Ferizajit C. nr. 409/06, të 7 shkurtit 2008;
- *Rasti KI 04/12. Aktgjykim. Parashtrues: Esat Kelmendi. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 647/2011, të 30 nëntorit 2011.* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Nr. Ref.: AGJ 285/12. Prishtinë, më 20 korrik 2012;
- *Rasti KI 06/10. Aktgjykim. Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë.* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, 30 tetor 2010 Nr. Ref.: AGJ 63/10;
- *Rasti KI 07/17. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Pashk Mirashi Vleresim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 228/2016, te 20 tetorit 2016 dhe Aktgjykimit t*ë *Gjykatës s*ë *Apelit, PAKR nr. 231/2015, të 6 gushtit 2015.* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë: 12 qershor 2017. Nr. ref.: RK 1091/17;
- *Rasti KI 100/10. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtruesi: Eduard Thaqi (gjithashtu i njohur si Sokol Thaqi) Vleresim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Policisë së Kosoves, Nr. 398SHPK-2002, të 22 tetorit 2002;*
- *Rasti KI 101/10. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Ismet Hebibi. Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. I. Nr. 165/2004, të 9 nëntorit 2004*;
- *Rasti KI 106/12. Aktgjykim. Parashtrues: Bajrush Gashi. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, Pzd. nr. 67/2011, të 12 dhjetorit 2011.* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, më 27 qershor 2012. Nr. ref.:AGJ262/12);
- *Rasti KI 107/16. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Safet Muhaxheri dhe të tjerët. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për* çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimi;
- *Rasti KI 11 /09. Vendim për Heqjen nga Lista të Kërkesës. Parashtrues: Tomë Krasniqi. Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 2.1 të Urdhëresës Administrative të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) Nr. 2003/12, dhe nenit 20.1 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës, Ligji Nr. 02/L-47*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, 30 maj 2011. Nr. ref.: VHL 112/11;
- *Rasti KI 11/09. Vendim. Masë e Përkohshme/MP/. Parashtrues: Tomë Krasniqi kundër RTK-së dhe të tjerëve.* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë: 16 tetor 2009. Akti Nr. MP 01/09.
- *Rasti KI 118/14. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Raiffeisen Bank Kosovo J. S. C. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 24/2013, te 5 shkurtit 2014*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Nr. ref.:RK777/15. Prishtinë, 9 mars 2015;
- *Rasti KI 12/12. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtruesi: Reshat Murati. Kërkesë për*

vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Mitrovicë, E. nr. 709/2006, të 10 dhjetorit 2007;

- *Rasti KI 121/10. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Sitaram Chaulagai, Krishna Bandur Chamlagai, Chandra Kala Chauhan, dhe Hom Bahadur Battarai. Vlerësim i kushtetutshmërisë se vendimeve te Gjykatës se Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë GJL. nos. 1258/2010, 1259/2010, 1260/2010, 1261/2010, të 22 nëntorit 2010;*
- *Rasti KI 129/11. Aktgjykim. Parashtrues: Viktor Marku. Vlerësim i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. Dr. 158/2011 të 5 korrikut 2011 dhe vendimit nr. 02/197/2010 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës nga ana e Komunës së Klinës*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Nr. ref.: AGJ/282/12. Prishtinë, më 17 korrik 2012;
- *Rasti KI 132/15. Aktgjykim. Parashtrues: Manastiri i Deçanit. Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dy vendimeve të 12 qershorit 2015, nr. AC-I-13-0008 dhe nr. AC-I-13-0009, të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, më 20 maj 2016. Nr. ref.: AGJ943/16;
- *Rasti KI 134/11, KI 135/11, KI 136/11, KI 137/11. Avendim për Papranueshmëri. Parashtruesit: Enver Gashi, Shefqet Bici, Ibush Gela, Mustafë Emini. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së 4 Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës;*
- *Rasti KI 14/09. Vendim për Papranueshmëri. Trashëgimtarët e Ymer Loxhes dhe Sehit Loxhes kundër Vendimit Nr. PKL. Nr. 21/07 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, i datës 17 dhjetor 2008;*
- *Rasti KI 150/16. Aktgjykim. Parashtrues: Mark Frrok Gjokaj Vleresim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës* së Kosovës, CLM. nr. 11/2016, të 13 shtatorit 2016. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, më 31 dhjetor 2018. Nr. ref.: AGJ 1314/18;
- *Rasti KI 159/15. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Sabri Ferati. Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë se Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN. nr.499/2015, të 29 shtatorit 2015*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë: 13 qershor 2016. Nr. ref.: RK947/16;
- *Rasti KI 178/18. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Bujar Hoti. Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës së 1 marsit 2013*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, më 27 mars 2019 Nr. ref.: RK 1330/19;
- *Rasti KI 18/09. Vendim për Papranueshmëri. Reshat Karanxha kundër Këshillit Gjyqësor të Kosovës;*
- *Rasti KI 18/10. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtruesit: z. Denie D. Mladen dhe z. Vitkovie-Deniq D. Milorad. Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykates Supreme të Kosovës, Cml. Gzz. nr. 36/2007, të 13 dhjetorit 2007*;
- Rasti KI 19/09. Tomë Krasniqi vs. RTK dhe KEK. Mendim Mospajtues: Gjyljeta Mushkolaj. Datë: 23 tetor 2009;
- *Rasti KI 20/09. Vendim për Papranueshmëri. Petrit Morina kundër Aktgjykimit AP.Nr.495!2003 të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 7 prill 2004*;
- *Rasti KI 21/09. Vendim. Parashtrues: Agim Kryeziu kundër Komunës së Prizrenit*;
- *Rasti KI 22/11. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues. Bojana Denić. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, A. Nr. 263/2010, të 12 nëntorit 2010;*
- *Rasti KI 25/10. Aktgjykim. Parashtrues: Agjencia Kosovare e Privatizimit. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC 09—089, të 4 shkurtit 2010*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë: 31 mars 2011. Nr. Ref.: AGJ 109/11;
- *Rasti KI 26/09. Vendim për Papranueshmëri. Ekrem Gashi kundër Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës*;
- *Rasti KI 28/11. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues Ismet Boshnjaku Vleresim i Aktg-*

jykimit të Gjykates Supreme (Rev. Nr. 225/2007), të 25 shtatorit 2000;

- *Rasti KI 34/10. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtruesi: Bislim Kosumi kundër Gjykatës Komunale në Podujevë;*
- *Rasti KI 34/17. Aktgjykim. Parashtrues: Valdete Daka. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK nr. 50/2017, të 6 marsit 2017*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, më 12 qershor 2017. Nr. ref.: AGJ 1092/17;
- *Rasti KI 36/11. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Arjeta Halimi. Vlerësimi i kushtetutshmërisë të mos-përmbarimit të pretenduar të Aktgjykimit CN. nr. 24/09, të 17 nëntorit 2009, të Gjykatës së Qarkut në Gjilan dhe shkeljes së pretenduar të të drejtave të njeriut të parashtruesit të kërkesës.* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë. Datë: 30 shtator 2011. Nr. ref.: RK 137/11;
- *Rasti KI 37/10. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Nebojsa Stanojevic, Dragan Marinkovic dhe 118 ish të punësuarit "N.SH. Banja e Kllokotit". Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme Nr. SCEL-06-0016 të datës 10 tetor 2006 dhe Aktvendimit Nr. SCEL 06-016 të datës 31 janar 2007*;
- *Rasti KI 39/19. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Raif Maloku. Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë se Aktvendimit te Gjykatës së Apelit, AC. nr. 4981/2017, të 15 majit 2018.* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, më 18 shkurt 2020 Nr. ref.: RK 1516/20;
- *Rasti KI 40/09. Aktgjykim. Imer Ibrahimi dhë 48 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) kundër 49 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, më 23 qershor 2010. Nr. ref.: AGJ 30/10;
- *Rasti KI 40/19. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Alije Shabani, Lulëzim Shabani, Luljeta Shabani dhe Kujtim Shabani. Vlerësim i kushtetutshmërisë* së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 394/2018, te 14 janarit 2019. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë: 7 tetor 2019. Nr. Ref.: RK 1440/19;
- *Rasti KI 41/09. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues. Universiteti AAB – RIINVEST L.L.C, Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës;*
- *Rasti KI 41/12. Aktgjykim. Parashtrues: Gëzim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, më 26 shkurt 2013. Nr.ref.:AGJ 361/13;
- *Rasti KI 47/10. Aktgjykim. Naim Rrustemi dhe 31 Deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës kundër Shkëlqesisë së Tij Fatmir Sejdiut, President i Republikës së Kosovës*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë: 28 shtator 2010. Ref. Nr. AGJ 43/10;
- *Rasti KI 47/12. Aktgjykim. Parashtrues: Islam Thaçi. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme Rev. Nr. 188/2009, të 7 dhjetorit 2011*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Nr.ref.: AGJ / 278/12. Prishtinë, më 16 korrik 2012;
- *Rasti KI 47/17. Aktgjykim. Parashtrues: Valdete Daka. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK nr. 50/2017, të 6 marsit 2017*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Nr. ref."AGJ 1092/17. Prishtinë, më 12 qershor 2017;
- *Rasti KI 48/10. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Naser Rexhepi. Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimit të Gjykatës Ekonomike te Qarkut VI.C.nr 54/2003, të15 prillit 2003 dhe Vendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës Ac.nr 39/2003, të 19 qershorit 2003;*
- *Rasti KI 48/18. Aktgjykim. Parashtrues: Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit AA. nr. 52/2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të 25 nëntorit 2017 dhe Aktgjykimit A.A. U. ZH. nr. 62/2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të 7 dhjetorit 2017*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, më 4 shkurt 2019. Nr. ref.: AGJ 1322/19;
- *Rasti KI 50/12. Aktgjykim. Parashtruesi Agush Lolluni. Vlerësim i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 153/2011, të 4 tetorit 2011, dhe Vendimit Nr. 02 (207) 2010, të 4 tetorit 2010, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës nga komuna e Junikut*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Nr. ref.:

AGJ/279/12. Prishtinë, më 16 korrik 2012;

- *Rasti KI 54/16. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Ramadan Demirovic. Vlerësim i kushtetutshmërisë se Aktgjykimit te Kolegjit te Apelit të Gjykatës Supreme të Agjencisë Kosovare të Pronës, GSK-KPA-A-002/14, të 14 tetorit 2015;*
- *Rasti KI 55/11. Aktgjykim. Parashtrues: Fatmir Pireci. Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 518/2010, të 26 nëntorit 2010.* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Nr. ref.: RK/277/12. Prishtinë, më 16 korrik 2012;
- *Rasti KI 55/17. Aktgjykim. Parashtrues: Tonka Berisha. Vlerësim i kushtetutshmërisë* së Vendimit KGJ nr. 13/2017, të Këshillit *Gjyqësor* të Kosovës, të 13 janarit 2017. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Nr. ref.: AGJ 1106/17. Prishtinë, 17 korrik 2017;
- *Rasti KI 56/09. Aktgjykim. Parashtruesit: Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit.* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, 22 dhjetor 2010. Nr. Ref.: RK 77/10;
- *Rasti KI 58/11. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtruesi: Syle Shlivova. Vlerësim i kushtetutshmërisë* të Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 82/2002, të 21 gushtit 2002;
- *Rasti KI 63/09. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtruesi: Bajram Santuri. Vlerësim i kushtetutshmërisë* së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren c. nr. 368/2000, të 8 majit 2003, Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. 46/2005 (C. nr. 99/07), të 28 dhjetorit 2006, si dhe të vendimeve të gjykatave në Suedi dhe aktgjykimeve Nr. 8329/06 dhe 9095/07 të *Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*;
- *Rasti KI 68/09. Vendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Emrush Kastrati kundër Vendimit te Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. Nr. 120/08, të datës 1 shtator 2009*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, 21 qershor 2010 Nr. ref.: RK *16/10;*
- *Rasti KI 69/10. Aktvendim për Papranueshëri. Parashtrues: Vehbi Halili. Vlerësim i kushtetutshmërisë* së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 5/2004, të 10 shkurtit 2004;
- *Rasti KI 72/10. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtruesi: AGEF Gmbh përmes përfaqësuesve të autorizuar. Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Kuvendit Komunal të Prishtinës Nr. 353-1297, të datës 29 qershor 2010;*
- *Rasti KI 84/19. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Merita Ramadani. Kërkesë për vlerësimin e Aktvendimit të Gjykatës se Apelit Ae. Dr. 279/18, te 30janarit 2019.* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, më 9 dhjetor 2019 Nr. ref.: R.K 1476/19;
- *Rasti KI 88/10. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Agim Paca kundër Enver Hasanit, ish- Rektor në Universitetin e Prishtinës*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Nr. Ref: RK 77/10. Prishtinë, 22 dhjetor 2010;
- *Rasti KK 124/14. Aktvendim. Hetimi për pretendimet e sjelljes jokushtetuese nga gjyqtari Kadri Kryeziu.* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Nr. ref.: 698/14. Prishtinë, më 20 gusht 2014;
- *Rasti KO 01/09. Aktgjykim. Parashtrues: Qemajl Kurtishi dhe Kuvendi Komunal i Prizrenit.* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë. Datë: 18 mars 2010. Ref. Nr. AGJ 07/10;
- *Rasti KO 01/17.Aktgjykim. Parashtrues: Aida Dërguti dhe 23 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, 4 prill 2017. Nr. ref.: AGJ1053/17;
- *Rasti KO 04/11. Aktgjykim. Parashtrues: Gjykata Supreme e Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë se neneve 35, 36, 37 dhe 38 te Ligjit për shpronësimin e pronës se paluajtshme, Nr. 03/L-139*;
- *Rasti KO 07/09. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Deme KURBOGAJ dhe Besnik KURBOGAJ kundër Aktgjykimit te Gjykatës Supreme Pkl.nr. 61/07 të 24 nëntorit 2008, Aktgjykimit te Gjykatës Supreme Nr. Ap.nr. 510/2007 të 26 marsit 2008;*
- *Rasti KO 09/13. Aktgjykim. Konfirmim i amendamentit të propozuar kushtetues, të paraqitur nga Kryetari i Kuvendit të Republikës* së Kosovës, më 18 janar 2013, *nëpërmjet shkresës Nr.*

04-DO-1357. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Nr. ref.: AGJ 367/13. Prishtine, me 29 janar 2013;

- *Rasti KO 108/13. Aktgjykim. Parashtrues: Albulena Haxhiu dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit, Nr. 04/L-209, për Amnisti*;
- *Rasti KO 118/13. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Albana Fetoshi dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 04/L-201 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, më 9 shtator 2013. Nr.ref·: RK 470/13;
- *Rasti KO 118/16. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Slavko Simić dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën.* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, më 31 Tetor 2016 Nr. ref.:RK986/16;
- *Rasti Ko 119/10. Aktgjykim. Parashtrues: Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 14 paragrafit 1.6, nenit 22, nenit 24, nenit 25 dhe nenit 27 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, Nr. 03/L111, të 4 qershorit 2010*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë. Datë: 8 dhjetor 2011. Nr. ref.:AGJ 165/11;
- *Rasti KO 119/14. Aktgjykim. Parashtrues: Xhavit Haliti dhe 29 deputete të tjerë te Kuvendit te Republikës se Kosovës Vlerësim i kushtetutshmërisë se Vendimit Nr. 05-V-001, te votuar nga 83 deputete te Kuvendit te Republikës se Kosovës për zgjedhjen e Kryetarit te Kuvendit te Republikës se Kosovës, te 17 korrikut 2014.* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë: 26 gusht 2014. Nr. Ref.: AGJ 700/14;
- *Rasti KO 126/16. Aktvendim. Gjykata referuese: Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën*;
- *Rasti KO 13/15. Aktgjykim. Vlerësim i një amendamenti të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të propozuar nga pesëdhjetë e pesë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe të referuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 6 shkurt 2015 me shkresën nr. 05-259/DO-179.* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë. Datë: 16 mars 2015. Nr. ref.: AGJ 782/15;
- *Rasti KO 131/12. Aktgjykim. Parashtrues: Dr. Shaip Muja dhe 11 deputet1 të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 18, 19,41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi, Nr. 04/L-125, të miratuar nga Kuvendi, më 13 dhjetor 2012*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, më 15 prill 2013. Nr. ref.: AGJ 404/13;
- *Rasti KO 131/18. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Presidenti i Republikës së Kosovës. Kërkesë për vlerësim të konfliktit në mes të kompetencave kushtetuese të Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës, siç është përcaktuar me nenin 113.3 (1) të Kushtetutës*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, 25 mars 2019. Nr. ref.: RK 1339/19;
- *Rasti KO 142/16. Aktgjykim. Parashtrues: Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 10 dhe 40.1.5 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, më 18 korrik 2017. Nr. ref.:AGJ 1107/17;
- *Rasti KO 155/14. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Dekretit të Presidentes së Republikës së Kosovës* për konfirmimin e vazhdimit të mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. DKGJK-001-2014, të 31gushtit 2014. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Nr. ref.: RK732/14. Prishtinë: më 13 nëntor 2014;
- *Rasti KO 18/14. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Vesna Mikic dhe 20 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kërkesë për"[...] interpretim të dispozitave të Kushtetutës së Kosovës lidhur me vendet e rezervuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë"*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Nr.ref.: RK 551/14.

Prishtinë, më 11 shkurt 2014;

- *Rasti KO 22/15. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës. Kërkesë për rishqyrtim të Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në Rastin K0155/14,të 13 nëntorit 2014.* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Nr. ref.: RK792/15. Prishtinë, më 30 prill 2015;
- *Rasti KO 26/15. Aktgjykim. Vlerësim i amendamentit të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe referuar më 9 mars 2015 nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, me Shkresën nr. 05-433/DO-318*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë. Datë: 15 prill 2015. Nr. ref.: AGJ 788/15;
- *Rasti KO 29/11. Aktgjykim. Parashtruesit: Sabri Hamiti dhe deputetë të tjerë. Vlerësimi i kushtetutshmërisë të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, i datës 22 shkurt 2011*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë. Datë: 30 mars 2011. Nr. ref.: AGJ 107/11;
- *Rasti KO 38/12. Aktgjykim. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Propozimeve të Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës, të dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës më 12 prill 2012*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Nr. ref.:AK 234 /12. Prishtinë, më 15 maj 2012;
- *Rasti KO 43/19. Aktgjykim. Parashtrues: Albulena Haxhiu, Driton Selmanaj dhe tridhjetë deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. o6/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, më 27 qershor 2019. Nr. ref.: 1387/19;
- *Rasti KO 45/12 dhe KO 46/12. Aktgjykim. Kërkesa e Liburn Aliut dhe 11 deputetëve të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit për fshatin Hoç*ë e Madhe dhe të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtine. Datë: 25 qershor 2012. Nr.Ref.:AGJ 255/12;
- *Rasti KO 54/20. Aktgjykim. Parashtrues: Presidenti i Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 01/15 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të 23 marsit 2020.* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, më 6 prill 2020. Nr. ref.: AGJ 1543/20;
- *Rasti KO 57/12. Aktgjykim. Kërkesa e Presidentes së Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë* së Saj, Atifete Jahjaga, me të cilën konteston votimin për miratimin e Ligjit nr. 04/1-084"Për pensionet e *pjesëtareve* të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Nr. ref.: AGJ297/12. Prishtinë, më 20 shtator 2012;
- *Rasti KO 59/14 Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Hilmi Hoxha. Vlerësimi i kushtetutshmërisë* së neneve 29.2 dhe 38.2 të Kodit të Procedurës Penale dhe të neneve 11.1dhe 39.2 të Ligjit për gjykatat. Nr. ref.: RK 672/14;
- *Rasti KO 73/16. Aktgjykim. Parashtrues: Avokati i Popullit. Vlerësim i kushtetutshmërisë se Qarkores Administrative nr. 01/2016, të nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike të Republikës së Kosovës, me 21 janar 2016*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë. Datë: 8 dhjetor 2016 Nr. ref.:AGJ 1015/16;
- *Rasti KO 79/18. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Presidenti i Republikës së Kosovës. Kërkesë për interpretim të nenit 139. paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë. Datë: 3 dhjetor 2018. Nr. ref.: RK 1294/18;
- *Rasti KO 80/10. Aktgjykim. Parashtrues: Kërkesa e Presidentit te Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së tij Dr. Fatmir Sejdiu, për sqarim të kompetencave në rastin e kryetarit të Rahovecit, z. Qazim Qeska*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë. Datë: 7 tetor 2010. Ref. nr. AGJ 46110;
- *Rasti KO 94/16. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Slavko Simić dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, nr. 05/L-010*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, më 25 tetor 2016. Nr. ref.: RK981/16;
- *Rasti KO 95/13. Aktgjykim. Parashtrues: Visar Ymeri dhe 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Re-*

publikës së Kosovës Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit, Nr. 04/L-199, për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të Planit të zbatimit për këtë marrëveshje. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Nr. ref.:AGJ469/13. Prishtinë, më 9 shtator 2013;

- *Rasti KO 97/10. Aktgjykim. Në çështjen e kërkesës së parashtruar nga Ushtruesi i Detyrës së Presidentit, Dr. Jakup Krasniqi, lidhur me mbajtjen e postit të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit dhe njëkohësisht të postit të Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Demokratike të Kosovës.* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Nr. Ref.: AGJ 78/10. Prishtinë, më 22 dhjetor 2010;
- *Rasti KO 97/12. Aktgjykim. Parashtrues: Avokati i Popullit Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve: 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116, të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë. Datë: 12 prill 2013. Nr. ref.: AGJ 403/13;
- Rasti nr. K061j12, parashtrues i kërkesës: *Kryetari i Kuvendit te Republikës së Kosovës,* Aktgjykim i 31 tetorit 2012);
- *Rasti Nr. KO 04/11. Aktgjykim. Parashtruesi: Gjykata Supreme e Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 35, 36, 37 dhe 38 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme, Nr. 03/L-139*. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, më 01 mars 2012. Nr. ref.: AGJ 203/12;
- *Rasti. K0 130/15. Aktgjykim. Parashtrues: Presidentja e Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar "Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore" me frymën e Kushtetutës, me nenin 3.1 [Barazia para Ligjit], me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, 23 dhjetor 2015. Ref. Nr.: 1877/15;
- *REGULATION NO. 1999/24.UNMIK/REG/1999/24. 12 December 1999. ON THE LAW APPLICABLE IN KOSOVO;*
- *REGULATION NO.1999/1.UNMIK/REG/1999/1.25 July 1999 ON THE AUTHORITY OF THE INTERIM ADMINISTRATION IN KOSOVO;*
- Rekomandimi CM/Rec. 14 (2007) të Komitetit të Ministrave të KE;
- Resolution 1244 (1999). *Adopted by the Security Council at its 4011th meeting, on 10 June 1999*. Security Council. S/RES/1244 (1999);
- Rregullore nr. 1999/24 për Ligjin në Fuqi në Kosovë (12 dhjetor 1999);
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/13 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Ndërlidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, me ndryshime. Datë: 13 qershor 2002;
- *Rules of the Court. Promulgated under the Government Notice R1675 in Government Gazette 25726 of 31 October 2003*;
- Spain's Constitution of 1978 with Amendments through 2011. Në internet: https://www.constituteproject. org/ constitution/Spain_2011.pdf?lang=en (shikuar në korrik 2019);
- *Special Act of 6 January 1989 on the Constitutional Court*. Në internet: https://www.const-court.be/en/common/home.html (shikuar më 31 korrik 2019);
- *Steck-Risch dhe të tjerët kundër Lihtenshtajnit* (dec), nr. 29061/08, 11 maj 2010. *2. The proceedings in the case of* Steck-Risch and Others v. Liechtenstein*, application no. 63151/00;*
- *The 1945 Constitution of the Republic of Indonesia As amended by the First Amendment of 1999, the Second Amendment of 2000, the Third Amendment of 2001 and the Fourth Amendment of 2002*;
- *The Act of 1 August 1997 on the Constitutional Tribunal, Dz. U. No. 102, item 643, with d*. Në internet: https://palestrapolska.wordpress.com/2015/11/28/tk-iudex-suspectusiudex-inhabilis-przepisy-i-orzecznictëo/ (shikuar në mars 2018);
- *The Constitution of Barbados, 1966 (as amended up to 2007);*

- *The Constitution of El Salvador of 1983 with Amendments through 2014;*
- The Constitution of Guatemala of 1985 with Amendments through 1993;
- *The Constitution of the Arab Republic of Egypt 1971 (as amended up to 2007).* Në internet: http:// www. wipo.int/ wipolex/ en/ details. jsp?id=7140 (shikuar në korrik 2017);
- *The Constitution of the Islamic Republic of Iran of 1979 with Amendments through 1989*. Në internet: https://www.constituteproject.org/constitution/Iran_1989.pdf?lang=en (shikuar në korrik 2017);
- *The Constitution of the Islamic Republic of Pakistan of 1973 with amendments through 2017*;
- *The Constitution of the Italian Republic*. (Gazzetta Ufficiale 27 dicembre 1947, n. 298). Në internet: http://www.ces.es/ TRESMED/docum/ita-cttn-ing.pdf (shikuar më 29 korrik 2019);
- The Constitution of the Republic of Poland of 2nd April, 1997. Në internet: https://www. sejm. gov. pl/ prawo / konst/angielski/kon1.htm (shikuar në korrik 2019);
- *The Constitution of the Republic of South Africa of 1996*. *As adopted on 8 May 1996 and amended on 11 October 1996 by the Constitutional Assembly*;
- *The Constitution of the Republic of Trinidad and Tobago of 1976*;
- *The Constitutional Court Regulation No. 06/PMK/2005 Regarding Court Proceeding Guidance in Judicial Review Cases.* Published 2005;
- *THE LAW OF AZERBAIJAN REPUBLIC ON CONSTITUTIONAL COURT of 23 December 2003*;
- *The Law on Constitutional Court Procedure of Mongolia of 1997*;
- *The Law on the Establishment and Judgement Procedures of the Constitutional Court* (No. 44, 22 April 1962);
- *The Ottoman Constitution* (23 December 1876);
- Tribunal Constitutional Act. 17 October 1997. Articles 59-81 ["Parimet, Procedura e Gjykimit dhe e Zbatimit të Vendimeve"]. Në internet: https://www.refworld.org/docid/3ae6b53b10.html (shikuar në korrik 2019);
- Tumey v. Ohio, 273 U.S. 510 (1927). U. S. Supreme Court. Në internet: https://supreme.justia. com/cases/ federal /us/273/510/case.html (shikuar në prill 2018);
- *Tunisie. Constitution du 27 janvier 2014.* Në internet: http://mjp.univ-perp.fr/constit/tn2014. htm#5 (shikuar në korrik 2017);
- U.S. Supreme Court. Bradley v. Fisher, 80 U.S. 13 Wall. 335 335 (1871);
- Udhëzim Administrativ Nr. MSHP 2004/07 për Udhëtimet Zyrtare i datës 20.10.2004. Arkivi i MSHP. Qeveria e Republikës së Kosovës. Prishtinë;
- UN Basic Principles on the Independence of the Judiciary. Në internet: https://www.un.org/ ruleoflaw/ blog/ document/ basic-principles-on-the-independence-of-the-judiciary/ (shikuar në prill 2018);
- United Mizrahi Bank v. Migdal Cooperative Village. CA 6821/93. Decided November 1994. Për tekstin e plotë të aktgjykimit, shih në internet në këtë vegëz: http:// versa. cardozo. yu.edu/ sites/ default/ files/upload/ opinions/ United %20 Mizrachi % 20Bank%20v.%20Migdal%20 Cooperative%20Village_0.pdf (shikuar më 20 qershor 2019);
- United States v. Will, 449 U.S. 200 (1980). U. S. Supreme Court. Në internet: https://supreme. justia.com/ cases /federal/us/449/200/case.html (shikuar në prill 2018);
- *Ustavni zakon o Ustavnom sudu Republike Hrvatske* ("Narodne novine"broj 99/99., 29/02. i 49/02. - pročišćeni tekst). Në internet: https:// www.zakon.hr/z/137/Ustavni-zakon-o-Ustavnom-sudu-Republike-Hrvatske (shikuar në prill 2018);
- VEND1M PER MOSPERMBARIM në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, të 17 dhjetorit 2010 në rastin nr. KI 08/09 Sindikata e Pavarur e Punonjësve të Fabrikës së Çelikut, IMK, në Ferizaj, e përfaqësuar nga z. Ali Azemi, kryetar i Sindikatës - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit c. Nr. 340/2001, të 1 janarit 2002. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 6 dhjetor 2012. Në internet: https://gzk.rks-gov.net/Act Detail. Aspx? ActID=3213 (shikuar së fundi më 2 shtator 2010);
- Vendim i Gjykatës Kushtetues të Sllovenisë U-I-196/97 i datës 29.10.1997);
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë U-I-3760/2007 et al, i datës 08.12.2010);

- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Çeke I. US 394/97 i datës 04.03.1998);
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës të Afrikës së Jugut CCT 23/96 i datës 06.09.1996);
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë nr. 57 i datës 04.11.1998);
- Vendimi i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës që miraton Raportin dok. 12462, të 7 janarit 2011;
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Federale të Gjermanisë nr. 1BvR 1693/92 i datës 8 shkurt 1994). Teksti i plotë në internet: https://dejure.org/dienste/vernetzung/rechtsprechung?Gericht=BVerfG&Datum=08.02.1994& Aktenzeichen=1%20BvR%201693%2F92;
- Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04- V- 436 të datës 7 shtator 2012, *Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20 dt. 5 gusht 2015;*
- *Vendimin lidhur me kërkesën për përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 17 prillit 2015*;
- Vendimin nr. 547/14 të Qeverisë së Republikës së Kosovës;
- *Vienna Convention on Diplomatic Relations* (1961). Në internet: http://legal.un.org /ilc/texts/instruments/english/co n ventions/9_1_1961.pdf (shikuar në prill 2018);
- Vienna Convention on the Law of Treaties 1969. Në internet: https://legal.un.org/ilc/texts/instruments /english/conventions/111969.pdf.

D. MATERIALE TË TJERA:

- "Enver Hasani, vazhdimisht jam kërcënuar dhe shantazhuar", BOTAT SOT 18 dhjetor 2014;
- "Freedom in the World 2017: Marocco". *FREEDOM HOUSE REPORT 2017*;
- "Hasani denoncon kërcënimet ndaj tij", KOSOVA SOT (24 shtator 2014);
- "Hasani ndihet i shantazhuar nga politika", KOSOVA SOT 26 nëntor 2014;
- "Hasani porosit Bllokun: Mos kërcënoni!", LAJM (16 tetor 2014);
- "Hasani: Videoja ka lidhje me aak-në, po më hakmerren për vendimet e Gjykatës", KOHA DITORE 25 nëntor 2014;
- "Këndellet Isa Mustafa", LAJM (24 September 2014);
- "Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, i shantazhuar e i kërcënuar! Heton policia", BOTA SOT (24 shtator 2014);
- "Kushtetuesja përgjigjet këtë javë", ZËRI (21 qershor 2014). (shikuar në shkurt 2020);
- "Kushtetuta i bën 'avokatin' presidentit". KOHA DITORE 15 mars 2019;
- "Nations in Transit – Kosovo 2012". *FREEDOM HOUSE*, fq. 279-295 në fq. 280, 286 & 291-292. Në internet: https://www.refworld.org/docid/4fd5dd2dc.html (shikuar në shkurt 2019); & "Nations in Transit – Kosovo 2013". *FREEDOM HOUSE*, Në internet: https://freedomhouse.org/sites/default/files/ NIT 13Kosovo2ndProof.pdf (shikuar në maj 2019);
- "Ngjarjet që karakterizuan vitin 2014", KOSOVAPRESS 31 dhjetor 2014. Në internet: available at http://www. kosovapress.com/sq/lajme/ngjarjet-qe-karakterizuan-vitin-2014-32251 (shikuar në korrik 2018);
- "Policia nis hetimet për skandalin e video-akuzës ndaj Enver Hasanit", BOTA SOT 26 nëntor 2014;
- "Shantazhohet e kërcënohet Enver Hasani, denoncon emra", TRIBUNA (24 shtator 2014);
- "Shantazhohet e kërcënohet Enver Hasani", LAJM (24 shtator 2014);
- "Zyrtare: pdk – 37 deputetë, partia e parë në zgjedhjet e 8 qershorit", TELEGRAFI (26 qershor 2014). Në internet: https://telegrafi.com/zyrtare-pdk-37-deputete-partia-e-pare-ne-zgjedhjet-e-8-qershorit (shikuar në shkurt 2020);
- *3rdCongress of the World Conference on Constitutional Justice "Constitutional Justice and Social Integration". 28 September – 1 October 2014. Seoul, Republic of Korea. Questionnaire. Reply by the Constitutional Court of Hungary. Fusnota nr. 8 dhe teksti që e shoqëron*. Në internet: https://www.venice.coe. int/ WCCJ/ Seoul / docs/ Hungary_CC _ reply questionnaire3WCCJ-E.pdf (shikuar së fundi në maj 2019);
- *Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in Respect of Kosovo. Advisory Opinion of 22 July 2010.* Në internet: https://www.icj-cij.org/files/case-related/141/141-20100722-ADV-01-00-EN.pdf (shikuar në shkurt 2020);
- Advisory Opinion no. 1 of 6 July 2012 of the Constitutional Court, concerning the proposal to suspend from office the President of Romania, Mr. Traian Băsescu; dhe"Ruling no. 6 of 21 August 2012 on the compliance with the procedure for the organization and conduct of the national referendum of 29 July 2012 for the dismissal of the President of Romania,

Mr. Traian Basescu, and on the confirmation of its results."Në European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Constitutional Issues in Romania. Decisions, Rulings and Opinions of the Constitutional Court (*Translations from Romanian provided by the Romanian Authorities*).* Opinion 685/2012. CDL-REF(2012)031 (Engl. only). Strasbourg, 5 September 2012;

- Alexandre Viala, *Les réserves d'interprétation dans la jurisprudence du Conseil constitutionnel*. Tome 92 (LGDJ: Paris, 1999) (disertacion phd);
- Altangerel Byambajargal, *A Study on the Problems and Improvement of Constitutional Review in Mongolia*. Graduate School of Kookmin University. Department of Law and Major of Law (2014). A Dissertation for the Degree of Ph.D.Në internet:http://kookmin.dcollection.net/common/orgVieë/000002065932 (shikuar në korrik 2017)
- Andreas Voßkuhle, Protection of Human Rights in the European Union. Multilevel Cooperation on Human Rights between the European Constitutional Courts. German Federal Constitutional Court, Karlsruhe, Germany. Session 6, Keynote Lecture: "Human Rights – Global Culture – International Institutions" Our Common Future, Hannover, November 4, 2010. Në internet: http://www.ourcommonfuture.de/fileadmin/user_upload /dateien/Reden/Vosskuhle.pdf (shikuar në shkurt 2018);
- Askar Jalalian & Parisa Anvari, "A comparative study of judicial control in Iran, U.S.A and Canada." *International Letters of Social and Humanistic Sciences Online: 2014-12-15 ISSN: 2300-2697* Vol. 44, Në internet: doi:10.18052/www.scipress.com/ILSHS.44.61 (shikuar në korrik 2017);
- Bandar Eid Al Harbi, "Constitutionalism, Constitutionalisation and Legitimacy: Reforming *Al-Shura* Council Law in Saudi Arabia". *A Thesis Submitted for the Degree of Doctor of Philosophy in Law* (Law School Brunel University London: November 2014). Në internet: https://bura.brunel.ac.uk/handle/2438/10606 (shikuar në korrik 2017);
- Bota sot, 2 prill 2015: "Pallaska: Ministri Kuçi dëshiron ta bëjë kryeprokuror Enver Hasanin", fq. 2;
- Bota sot, e hënë, 29 shtator 2014: "Gjykata Kushtetuese me kuorum, kthehet amerikani Carolan", fq. 12;
- Bota sot, e martë, 16 shtator 2014: "Bllokohet edhe Gjykata Kushtetuese! Reagon Enveri:, fq. 6;
- Bota sot, e martë, 16 shtator 2014: "Reagon Krasniqi: Gjyqtari Carolan, kredibil", fq. 5;
- Bota sot, e martë, 16 shtator 2014: "Zëvendësimi i gjyqtarit amerikan do të marrë shumë kohë", fq. 5;
- Carolan do të zëvendësohet nga një vendës. KOHA DITORE, datë 4 tetor 2016. Në internet: http://archive.koha.net/?id=27&l=135739 (shikuar në mars 2018);
- Conference of European Constitutional Courts, XIIth Congress (2002). *The relations between the Constitutional Courts and the other national courts, including the interference in this area of the action of the European courts.* Report of the State Court of Justice of Principality of Liechtenstein by Prof. Dr. Andreas Kley;
- Daniel C. K. Chow, *THE LEGAL SYSTEM OF THE PEOPLE'S REPUBLIC OF CHINA: IN A NUTSHELL* 2nd ed. (West Group: St Paul MN, 2009);
- Dean Spielmann, "Unravelling the Myth of Judicial Activism through Dialogue with National Courts: The Strasbourg Experience", a paper presented at the international conference organized by the Constitutional Court of the Republic of Latvia in cooperation ëith European Commission for Democracy through law (Venice Commission) (26-27 May 2016, Riga), fq. 324-336 në fq. 327. Në internet: http://www.satv.tiesa.gov.lv/en/ëp-content/uploads/sites/2/2017/06/ BookJudicial-activism-of-the-Constitutional-Court-in-a-Democratic State_ part _1 ENG.pdf (shikuar në shkurt 2019);

- Dušan Papadopolos, *AVNOJ i narodno oslobodilačka borba u Bosni i Hercegovini: 1942-1943: materijali sa naučnog skupa održanog u Sarajevu 22. i 23. novembra 1973. godine* (Rad:Beograd, 1974);
- E godasin Gjykatën, gazeta e përditshme"Express", 29 gusht 2012, e mërkurë, fq. 6;
- Edward Wong and Jonathan Ansfieldfeb, "Reformers Aim to Get China to Live Up to Own Constitution". *New York Times* 2 April 2013;
- Enver Hasani e përfundon mandatin në Gjykatën Kushtetuese'. KLAN KOSOVA 20:22, 16 qershor 2015. Në internet: https://klankosova.tv/enver-hasani-e-perfundon-mandatin-ne-gjykaten-kushtetuese-video/ (shikuar në janar 2020);
- Enver Robelli, "Doli prej zarfit, tash nuk del prej zyrës! "KOHA DITORE*,* Prishtinë, e martë, 10 korrik 2012;
- Enver Robelli, "Doli prej zarfit, tash nuk del prej zyrës!", gazeta e përditshme Koha ditore*,* 10 korrik 2012, e martë, fq. 10;
- Epoka e re, e martë 16 shtator 2014:"Krasniqi: Gjyqtari Carolan, kredibil", fq. 3;
- Epoka e re, e martë, 16 shtator 2014:"Kushtetuesja ka mbetur me 6 gjyqtarë efektiv", fq. 3;
- Ergun Ozbudun, *The Constitutional System of Turkey: 1876 to the Present* (PALGRAVE MACMILLAN: New York, 2011);
- EULEX-i po hetohet për keqpërdorime. KOHA DITORE, e mërkurë, 22 qershor 2016; Dorëhiqet gjyqtari Carolan. KOHA DITORE, datë 10 shtator 2016. Në internet: http:// archive. koha.net/?id=27&l=132005 (shikuar në mars 2018);
- Euroepan Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Turkey. Opinion on the Provisions of the Emergency Decree Law n° 674 of 1 September 2016 which Concern the Exercise of Local Democracy in Turkey*. Adopted by the Venice Commission at its 112th Plenary Session (Venice, 6-7 October 2017). Strasbourg, 9 October 2017. Opinion No. 888 / 2017. CDL-AD(2017)021 Or.Eng;
- European Charter of Local Self-Government. *European Treaty Series* No. 122 (Strasburg: 15. X. 1985);
- EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (Venice Commission), *OPINION 733 OF OCTOBER 2013 ON THE FINAL DRAFT CONSTITUTION OF THE REPUBLIC OF TUNISIA*. Adopted by the Venice Commission at its 96th Plenary Session (Venice, 11-12 October 2013). CDL-AD(2013) 032 Or. fr. (Strasbourg, 17 October 2013);
- EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION), *OPINION ON THREE LEGAL QUESTIONS ARISING IN THE PROCESS OF DRAFTING THE NEW CONSTITUTION OF HUNGARY*. Adopted by the Venice Commission at its 86th Plenary Session (Venice, 25-26 March 2011);
- EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (Venice Commission), *OPINION 733 OF OCTOBER 2013 ON THE FINAL DRAFT CONSTITUTION OF THE REPUBLIC OF TUNISIA*;
- EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION). CDL-JU (2003) 30 (Strasbourg, 18 September 2003). Report by Mr László Sólyom (Member, Hungary). Conference on "Constitutional Justice and the Rule of Law" on the occasion of the 10th anniversary of the Constitutional Court of Lithuania (Vilnius, 4-5 September 2003)
- EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (Venice Commission), *OPINION 733 OF OCTOBER 2013 ON THE FINAL DRAFT CONSTITUTION OF THE REPUBLIC OF TUNISIA,* paragrafët 27-37 ["The State and Religion"];

- EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (Venice Commission), *OPINION 733 OF OCTOBER 2013 ON THE FINAL DRAFT CONSTITUTION OF THE REPUBLIC OF TUNISIA;*
- EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (Venice Commission), *OPINION NO. 817/2015 OF 26 OCTOBER 2015 ON THE DRAFT INSTITUTIONAL LAW ON THE CONSTITUTIONAL COURT OF TUNISIA.* Adopted by the Venice Commission at its 104th Plenary Session (Venice, 23-24 October 2015). CDL-AD (2015) 024 Or. fr. (Strasbourg, 26 October 2015);
- EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION), *TURKEY: OPINION ON THE AMENDMENTS TO THE CONSTITUTION ADOPTED BY THE GRAND NATIONAL ASSEMBLY ON 21 JANUARY 2017 AND TO BE SUBMITTED TO A NATIONAL REFERENDUM ON 16 APRIL 2017*;
- EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION), *OPINION ON THE DRAFT CONSTITUTIONAL AMENDMENTS WITH REGARD TO THE CONSTITUTIONAL COURT OF TURKEY.* Opinion 296/2004. CDL-AD(2004)024 (Strasbourg, 29 June 2004);
- EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION), *DRAFT OPINION DRAFT LAW ON THE CONSTITUTIONAL COURT OF THE REPUBLIC OF AZERBAÏJAN.* OPINION N°172 / 2002, CDL (2002) 25 (Strasbourg, 5 March 2002);
- EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION), *OPINION ON THE DRAFT CONSTITUTION OF THE KYRGYZ REPUBLIC.* Opinion No. Opinion no. 582 / 2010. CDL-AD(2010)015 (version published on 21 May 2010) Adopted by the Venice Commission at its 83rd Plenary Session (Venice, 4 June 2010);
- EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION), *OPINION ON THE DRAFT CONSTITUTIONAL LAW ON THE CONSTITUTIONAL COURT OF TAJIKISTAN*. OPINION NO. 765/2014 *CDL-REF(2014) 013* (Strasbourg 10 April 2014);
- EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION), *Draft outline of main elements for an agreement on Kosovo*. CONFIDENTIAL (Council of Europe: Strasbourg, 31/08/98);
- EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION), *OPINION ON HUMAN RIGHTS IN KOSOVO: POSSIBLE ESTABLISHMENT OF REVIEW MECHANISMS.* Opinion no. 280 / 2004. CDL-AD (2004)033. Or. Engl. Strasbourg, 11 October 2004;
- European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), *Study on Individual Access to Constitutional Justice* (CoE: Strasbourg 2009). Study No. 538/2009 Adopted by the Venice Commission at its 85th Plenary Session (Venice, 17-18 December 2010);
- European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Models of constitutional jurisdiction* (Council of Europe Press: Strasbourg, 1994);
- European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *The role of the constitutional court in the consolidation of the rule of law* (Council of Europe Press: Strasbourg, 1994);
- European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), "Opinion on the Draft Law on the Constitutional Court of Montenegro." Adopted by the Venice Commission at its 76th Plenary Session (Venice, 17-18 October 2008). *Opinion 479 / 2008 CDL-AD(2008)030* Original: English (Strasbourg, 24 October 2008);
- European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Opinion on*

Three Legal Questions in the Process of Drafting the New Constitution of Hungary. Adopted by the Venice Commission at its 86th Plenary Session (Venice, 25-26 March 2011). *Opinion no. 614/2011*. CDL-AD(2011)001. Original. English (Strasbourg, 28 March 2011);

- European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), "The Competence of the Constitutional Court to Control the Conformity of Laws with International Treaties: New Trends in Constitutional Justice" *CDL-JU(2009)036* English only (Strasbourg, 17 November 2009);
- European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), "Comments on the Draft Law on the Constitutional Court of the Republic of Serbia*". Opinion no. 445/2007*, *CDL-AD* (2007) 039. Original: English (Strasbourg: 7 November 2007);
- European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), "The Competence of the Constitutional Court to Control the Conformity of Laws with International Treaties. New Trends in Constitutional Justice";
- European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), "Opinion on the Draft Law on the Constitutional Court and Corresponding Amendments of the Constitution of the Republic of Moldova" *Opinion no. 200/2002. CDL-AD (2002) 16* (Strasbourg, 15 July 2002);
- EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION), "Study on Individual Access to Constitutional Justice". Adopted by the Venice Commission at its 85th Plenary Session (Venice, 17-18 December 2010) *Study N° 538 / 2009 CDL-AD(2010)039rev. Original English* (Strasbourg, 27 January 2011);
- European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Report on Constitutional Amendment*. Adopted by the Venice Commission at Its Plenary Session (Venice, 11-12 December 2009). *CDL-AD (2010) 001. Study No. 469/2008* (Strasbourg, 19 January 2010). Në internet: www.venice.coe.int (shikuar në dhjetor 2018);
- European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Opinion on the Constitution of Serbia*, adopted by the Commission at its 70th plenary session (Venice, 17-18 March 2007). CDL-AD(2007)004. Opinion No. 405/2006. Or. Engl. Strasbourg, 19 March 2007. Paragrafët: 14-17 & 81. Në internet: http://www.venicecoe.int/webforms/documents/default. aspx? pdffile=CDL-AD(2007)004-e (shikuar në mars 2018);
- European Commission for Democracy through Law (Venice Commission), *The Compilation of Venice Commission Opinions, Reports and Studies on Constitutional Justice.* CDL-PI(2015)002. Or. Engl. Strasbourg, 1 July 2015, Në internet: http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-PI%282015%29002-e (shikuar në mars 2018);
- European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *The Composition of Constitutional Courts*, paragrafi 1.1 ["Systems of Appointment"]: European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Judicial Appointments*. Venice, 22 June 2007. Opinion No. 403 / 2006. CDL-AD(2007)028. Or. Engl. Paragrafët: 8-17. Në internet: http://www.venice.coe.int/webforms/documents/CDL-AD(2007)028. Aspx (shikuar në prill 2018);
- European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Report on the Independence pf the Judicial System. Part I: The Independence of Judges.* Adopted by the Venice Commission at its 82nd Plenary Session (Venice, 12-13 March 2010). Study No. 494 / 2008. CDL-AD(2010)004. Original: English. Strasbourg, 16 March 2010. Paragrafi 31 ["3. 3.The appointing and consultative bodies"]. Në internet: http://www.venice.Coe.int/ webforms/documents/CDL-AD(2010)004.aspx (shikuar në prill 2018);
- European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *The Compilation of Venice Commission Opinions, Reports and Studies on Constitutional Justice (Updated*). Strasbourg, 18 December 2017.CDLPI(2017)008. Original: English, paragrafi 4.7. Në internet:http://www.venice.coe.int/ webforms/docume nts/?pdf=CDL-PI(2017)008-e

(shikuar në prill 2018);
- European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Amicus Curiae Brief on the Immunity of Judges for the Constitutional Court of Moldova*. Adopted by the Venice Commission at Its 94th Plenary Session (Venice, 8-9 March 2013). 689/2012. CDL – AD (2013) 008. Original: English. Opinion Strasbourg, 11 March 2013. Në internet: https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2013)008-e (shikuar në prill 2018);
- European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Memorandum Reform of the Judicial System in Bulgaria. Conclusions* adopted by the Venice Commission at its 55th plenary session (Venice, 13-14 June 2003). Opinion N° 246/2003. Strasbourg, 20 June 2003. CDL-AD (2003)12 Or. Engl. Në internet: http://www.venice coe.int/ webforms/ documents/default. aspx?pdffile=CDL-AD(2003)012-e (shikuar në prill 2018);
- European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Opinion on the Draft Law on Judges and Prosecutor of Turkey*. Adopted by the Venice Commission at its 86th Plenary Session (Venice, 25-26 March 2011). Opinion No. 610 / 2011. Strasbourg, 29 March 2011. CDL-AD(2011)004 Or. Engl. Në internet: http://www. europarl.europa.eu/ meetdocs/2009 _2014/ documents/d-tr/ dv/ 112817/ 112817 en.pdf (shikuar në prill 2018);
- European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Opinion on Act CLI of 2011 on the Constitutional Court of Hungary.* Adopted by the Venice Commission at its 91st Plenary Session (Venice, 15-16 June 2012). Opinion no. 665 / 2012. Strasbourg, 19 June 2012. CDL-AD(2012)009 Or. Engl. Në internet: http://www.venice. coe.int/ webforms/ documents/default.aspx? pdffile=CDL-AD(2012)009-e (shikuar në pril 2018); European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Opinion on Proposals Amending the Drfat Law on the Amendments to the Constitution to Strengthen the Independence of Judges of Ukraine.* Adopted by the Venice Commission at its 97th Plenary Session (Venice, 6-7 December 2013). Opinion no. 747 / 2013. Strasbourg, 10 December 2013. CDL-AD(2013)034 Or.Engl. Në internet: http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2013)034-e (shikuar në prill 2018);
- European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Albania. Amicus Curiae Brief for the Constitutional Court on the Law on Transitional Evaluation of Judges and Prosecutors (the Vetting Law).* Strasbourg, 12 December 2016. Opinion No. 868/2016. CDL – AD (2016) 036. Original: English. Paragrafët 17 25. Në internet: http://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)036-e (shikuar në prill 2018);
- European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Amicus Curiae Brief. Opinion on the Law on the Cleanliness of the Figue of High Functionaries of the Public Administration and Elected Persons of Albania.* Strasbourg, 13 October 2009. Opinion no. 524/2009. CDL-AD (2009) 044. Original: English. Paragrafet 142-143 & 145. Në internt: http://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/?pdf=CDL-AD(2009)044-e (shikuar në mars 2018);
- European Commission for Democracy through Law (Venice Commission), *Turkey. Opinion on Emergency Decree Laws Nos. 667-676, Adopted Following the Failed Coup of 15 July 2016.* Adopted by the Venice Commission at its 109th Plenary Session (Venice, 9-10 December 2016). Opinion No. 865/2016. Strasbourg, 12 December 2016. CDL-AD (2016)037. Engl.only. Paragrafët 137-140. Në internet: http://www. venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)037-e (shikuar në prill 2018);
- European Commission for Democracy Through law (Venice Commission), *Opinion on Act CLI of 2011 on the Constitutional Court of Hungary.* Adopted by the Venice Commission at its 91st Plenary Session (Venice, 15-16 June 2012). Strasbourg, 19 June 2012. Opinion no. 665 / 2012 CDL-AD(2012)009. Or. Engl. Parag.: 26-33;
- European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), "The role

of the constitutional court in the consolidation of the rule of law" CDL-STD(1994)010 Or. Engl. Në *Science and technique of democracy No.10*. Proceedings of the UniDem Seminar organized in Bucharest on 8-10 June 1994 in co-operation with the Romanian Constitutional Court with the support of the Ministry of Foreign Affairs of Romania. Në internet: https://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-STD(1994)010-e (shikuar në korrik 2018);

- European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Report on Separate Opinions of Constitutional Courts.* Adopted by the Venice Commission at its 117th Plenary Session (Venice, 14-15 December 2018). Strasbourg, 17 December 2018. Opinion No. 932/2018. CDL – AD (2018) 030. Orig.: English. Në internet: https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2018)030-e;
- European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Albania. Draft Opinion on the Poëers of the President to Set Dates of Elections in a Parliamentary System*. Strasbourg, 29 September 2019 Opinion No. 959 / 2019 CDL(2019)027. Or. Engl.;
- European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Constitutional Issues in Romania. Decisions, Rulings and Opinions of the Constitutional Court (*Translations from Romanian provided by the Romanian Authorities*).* Opinion 685/2012. CDL-REF(2012)031 (Engl. only). Strasbourg, 5 September 2012;
- European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Compilation of Venice Commission Opinions, Reports and Studies on Constitutional Justice (Updated).* Strasbourg, 18 December 2017. CDL – PI (2017) 08. Or. English;
- European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Opinion on Amendments to the Act of 25 June 2015 on the Constitutional Tribunal of Poland.* Adopted by the Venice Commission at its 106th Plenary Session (Venice, 11-12 March 2016). Opinion No. 833/2015. Venice, 11 March 2016. CDL – AD (2016 (001). Or. Engl.;
- European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), "The Relationship Between International and Domestic Law". *Science and Technique of Democracy* No.5. CDL- STD (1995) 005 (Strasburg, 15 September 1993);
- European Commission Through Law (Venice Commission) in co-operation with the Constitutional Court of Montenegro and the OSCE, *Seminar on The Competence of the Constitutional Court to Control the Conformity of Laws With International Treaties.* CDL-JU(2009) 036 (Venice Commission, Strasbourg, 17 November 2009);
- European Commission, *Kosovo Progress Report 2014* (Brussels, 8.10.2014 SWD(2014) 306 final) Në internet:https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo -progress-report_en.pdf;
- European Court of Human Rights, *Derogation in time of emergency. Factsheet* (Press Unit: Strasbourg, 2017);
- European Court of Human Rights, *Practical Guide on Admissibility Criteria* (Council of Europe: Strasbourg, 2014);
- Evgeni Tanchev, "Activism in Constitutional Review Revisited", a paper presented at the international conference organized by the Constitutional Court of the Republic of Latvia in cooperation with European Commission for Democracy through law (Venice Commission) (26-27 May 2016, Riga), fq. 267-304 në fq. 267-268. Në internet: http://www.satv.tiesa.gov.lv/en/wp-content/uploads/sites/2/2017/06/Book_Judicial-activism-of-the-Constitu-

tionalCo urt-in-a-Democratic State_ part _1 ENG.pdf;
- Fitim Gashi, "Kushtetusja e rrëzon kërkesën e presidentit Thaçi". *Koha Ditore* (e martë, 26 mars 2019);
- Fitim Gashi, "Kushtetuesja ia bën 'avokatin' presidenti. "*Koha Ditore* (e premte, 15 mars 2019);
- Foli Kushtetuesja: Presidentja ka mandat pesëvjeçar, gazeta e përditshme "Epoka e Re", 7 korrik 20012, e shtunë, fq. 1 dhe 4-5;
- Fourth Protocol to the General Agreement on Privileges and Immunities of the Council of Europe. Paris, 16. XII. 1961. European Treaty Series - No. 36. Në internet: https:// rm.coe.int/CoERMPublic Common SearchServices/DisplayDCTMContent? documentId =090000 168006b643 (shikuar në mars 2018);
- *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*. Prishtinë: Nr. 25/ 14 nëntor 2011;
- *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*. Prishtinë: Viti III/ Nr. 33/ 15 korrik 2008;
- *Gazeta Zyrtareë e Republikës së Kosovës* nr. 26, 02 qershor 2008 (Viti III) Prishtinë;
- Group of States Against Corruption (GRECO), *Immunities of public officials as possible obstacles in the fight against corruption. Lessons learned from the three Evaluation Rounds (2000-2010) - Thematic Articles* (Council of Europe: Strasbourg, pdb). Në internet: https://rm.coe.int/16806cbfc6 (shikuar në prill 2018);
- Guido Neppi Modona, "Enhancing the Cooperation Between the Constitutional Court and the Judiciary: The Italian Experience". Në European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission). Report. CDL–JU(2014) 007. English only. Strasbourg, 12 May 2014. fq. 3-4. Në internet: http://www. venice. coe. int/ webforms /documents/ default. aspx?pdffile=CDL-JU(2014)007-e (shikuar në janar 2018);
- Gunārs Kūtris, "Authority of the Constitutional Court as the Precondition of Execution of the Decisions". Në European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Conference on Execution of the Decisions of Constitutional Courts: A Cornerstone of the Process of Implementation of Constitutional Justice*. Baku, Azerbaijan, 14-15 July 2008. CDL - JU (2008) 028. Engl. only. Strasbourg 2 September 2008. Në internet: https:// www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-JU(2008)028-e (shikuar më 8 korrik 2019);
- Halil Matoshi, "Populizmi kushtetues dhe Zarifja", gazeta e përditshme "Koha Ditore", 25 korrik 2012, e mërkurë, fq. 10;
- Hasani e kishte paralajmëruar presidentin Sejdiu se do të përfundonte në Kushtetuese. Në internet: http:// archive.koha.net/?id=&l=150512 (shikuar në mars 2018);
- HCJ 4885/03 Israel Poultry Farmers Association v. Government of Israel. *Israel Law Reports* [2004];
- Helmut Steinberger, në punimin e tij "Decisions of the constitutional court and their effects", botuar nga Venice Commission (ed), *Role of the Constitutional Court in the Consolidation of the Rule of Law* (Science and technique of democracy No.10, 1994, Në internet https://www.venice.coe.int/ëebforms/ documents/default.aspx?pdffile=CDL-STD%281994%29010-e, (shikuar në mars 2018);
- Il quadro delle tipologie decisorie nelle pronunce della Corte costituzionale", botuar në QUADERNO PREDISPOSTO IN OCCASIONE DELL'INCONTRO DI STUDIO CON LA CORTE COSTITUZIONALE DI UNGHERIA Palazzo della Consulta, 11 giugno 2010 a cura di M. Bellocci e T. Giovannetti (pjesa: 2. Le decisioni di merito. 2.1. Le decisioni di rigetto (infondatezza o manifesta infondatezza della questione). Në internet: https://www. cortecostituzionale.it/documenti/ convegni_ seminari/ STU% 20219 Tipologiadecisioni. pdf (shikuar më 17 korrik 2019);
- Inhuman treatment of people and illicit trafficking in human organs in Kosovo". Report|Doc. 12462| 07 January 2011. Në internet:http://assembly.coe.int/në/xml/XRef/Xref-XML2HT-

ML-en.asp?fileid=12608 &lang=en (shikuar në janar 2018);

- *International Conference on"The Influence of the ECHR Case-Law on National Constitutional Jurisprudence".* Kyiv, Ukraine, 13-16.10.2005. Extracts from CODICES Database of the Venice Commission. fq. 55. Në internet: http://www.venice.coe.int/files /courts%20 referring %20to% 20 the% 20 ECHR.pdf (shikuar në mars 2018);
- International Court of Justice, Agean Sea Continental Shelf Case, Greece vs. Turkey, *ICJ Reports* 1976;
- IX COMMISSION DES LOIS ET DES AFFAIRES CONSTITUTIONNELLES. (C) LA COUR CONSTITUTIONELLE, botuar në Le Fondation Friedrich Nauman*, LES ACTES DE LA CONFERENCE NATIONALE* (Cotonou, du 19 au 28 Fevrier 1990) (Editions ONEPI, 1990: Cotonou, République du Bénin);
- Jahjaga edhe katër vjet presidente, gazeta e përditshme "Zëri", 7 korrik 2012, e shtunë, fq. 1-2;
- Jahjaga: Mirupafshim në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016, gazeta e përditshme "Bota Sot", 7 korrik 2012, e shtunë, fq. 1 dhe 4-5;
- Jaka Kukavica, "(Rule of) Law in the Time of Covid-19: Warnings from Slovenia, VerfBlog, 2020/3/25. "Në internet: https://verfassungsblog.de/rule-of-law-in-the-time-of-covid-19 warnings-from-slovenia/. (shikuar në prill 2020);
- Javier Garcia Roca, "Effects, Enforceability and the Exceution of the Decisions of the Spanish Constitutional Court", a report by presented at the Seminar on the Execution of Decisions of the Constitutional Court Kyiv, Ukraine, 28-29 October 1999, organized by the European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), Strasbourg, 8 December 1999 Restricted CDL-JU (99) 28 Engl. Only., në seksionin 1.1 e tutje (fq. 2 bis). Në internet: https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-JU(1999)028-e;
- Jayshree Bajoria, "Pakistan's Constitution". *Washington Post Tuesday* March 11, 2008;
- Kemal Gözler, *Le pouvoir de révision constitutionnelle,* Thèse pour le doctorat en droit, Directeur de recherches: Prof. Dmitri Georges Lavroff, Université Montesquieu - Bordeaux IV, Faculté de droit, des sciences sociales et politiques, 1995 (disertacion phd);
- *Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian (KKGJE) Opinioni nr. 3 i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian për dijeni të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në lidhje me parimet dhe rregullat që rregullojnë sjelljen profesionale të gjyqtarëve, e në veçanti me etikën, sjelljen e papajtueshme dhe paanshmërinë, Strasburg, 19 nëntor 2002);*
- KMDLNJ: Presidente, mos e dekreto Selvete Gërxhaliu – Krasniqin. ZERI 03 dhjetor 2015. Në internet: http://zeri.info/aktuale/65353/kmdlnj-presidente-mos-e-dekreto-selvete-gerxhaliu-krasniqin/ (shikuar në prill 2018);
- Koha ditore, 26 shtator 2014:"Carolan rikthehet për ta zgjidhur ngërçin politik", fq. 1 & 3;
- Koha ditore, 8 mars 2015:"Smaka: Gjykata Kushtetuese, në shërbim të politikës ditore" fq. 8-9;
- Koha ditore, e diel, 6 korrik 2014: "Gjyqtarët politikë e zbehin kredibilitetin e Kushtetueses", fq. 8-9;
- Koha ditore, e hënë, 21 maj 2012: "ISKP, Zgjedhja e gjyqtarëve kushtetues e politizuar" fq. 6;
- Koha ditore, e martë, 16 shtator 2014" "Kushtetuesja pa kuorum për së paku një muaj", fq. 1 & 3;
- Koha ditore, e mërkurë, 24 shtator 2014: "Gjyqtari Carolan negocion kthimin në Kushtetuese", fq. 1 & 3;
- Koha ditore, e shtunë, 20 shtator 2014: "Jena bo me na kajt 'Rahoveci", fq. 10;
- Kosova sot, 2 gusht 2015: "Peshqit e mëdhenj' nuk janë të paprekshëm!" fq. 1 & 2-3;
- Kosova sot, 20 mars 2015: "Partitë nuk ndalen, ja skenari për Kushtetuesen" fq. 1 & 2-3;

- Kosova sot, 23 qershor 2015: ”Koalicioni qeveritar gllabëron Kushtetuesen” fq. 1 & 4;
- Kosova sot, 26 dhjetor 2017: ”Politika, armiku më i madh i drejtësisë”, fq. 5.
- Kosova sot, 4 mars 2015: ”Jahjaga ta dekretojë Lumezin” fq. 1 & 2-3;
- Kosova sot, 4 prill 2015: ”Denoncohet skenari mafioz i Hajredin Kuçit”, fq. 1 & 5.
- Kosova sot, e diel, 15 shtator 2013: ”Kushtetuesja, a po i bindet politikës?”fq. 1 & 2-3;
- Kosova sot, e hënë, 16 qershor 2014: ”Zbatim i brishtë i Kushtetutës”, fq. 4;
- Kosova sot, e martë, 10 shtator 2013: ”Depolitizimi shpëton KQZ-në dhe Kushtetuesen”fq. 2-3;
- Kosova sot, e martë, 16 shtator 2014:”Gjyqtari amerikan braktis Kushtetuesen”, fq. 1-2;
- Kosova sot, e martë, 26 dhjetor 2017:”Politika, armiku më i madh i drejtësisë”, fq. 5;
- Krenar Gashi, “Nations in Transit 2012: Kosovo”. *Freedom House* (2012);
- Kriszta Kovács, “Hungary’s Orbánistan: A Complete Arsenal of Emergency Powers, VerfBlog, 2020/4/06”. Në internet: https://verfassungsblog.de/hungarys-orbanistana-complete-arsenal-of-emergency-powers/. (shikuar në prill 2020);
- Kryetari i Komisionit kushtetues, Arsim Bajrami, konteston vendimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me amendamentet për zgjedhjen e presidentit, gazeta e përditshme ”Koha Ditore”, 7 korrik 2012, e shtunë, fq. 1 dhe 3;
- Kryetarja e Kushtetueses jashtëligjshëm në Komisionin për zgjedhjen e një gjyqtari. KOHA DITORE, 12 dhjetor 2017. Në internet: http://www.koha.net/arberi/62886/kryetarja-e-kushtetueses-jashteligjshem-ne-komisionin-per-z gjedhjen-e-nje-gjyqtari/;
- Kushtetuesja: I gjithë populli shpreson ta ketë Jahjagën 5 vjet në krye, gazeta e përditshme ”Koha Ditore”, 21 korrik 2012, e shtunë, fq. 3;
- Kuvendi anulon një konkurs shkaku i shkeljes ligjore të kryetares së Kushtetueses. KOHA DITORE, 17 dhjetor 2017. Në internet: http://www.koha.net/ arberi/63102/kuvendi-anulon-nje-konkurs-shkaku-i-shkeljes-ligjore-te-kryetares-se-kushtetueses/ (shikuar në shkurt 2018);
- Kuvendi me Rezolutë antikushtetuese, gazeta e përditshme ”Koha Ditore”, 8 korrik 2012, e diel, fq. 1 dhe 3;
- Kuvendi në hall me amendamentet jokushtetuese, gazeta e përditshme ”Koha Ditore”, 11 gusht 2012, e shtunë, fq. 1 dhe 3;
- Lajm, e martë, 16 shtator 2014: ”Dorëhiqet gjyqtari amerikan”, fq. 7;
- Lajm, e mërkurë, 17 shtator 2014: ”Shkak i dorëheqjes, zvogëlimi i pagës”, fq. 1 & 5;
- LDK ndihet e tradhtuar nga Thaçi, AKR shpreson në vullnetin e presidentes, gazeta e përditshme ”Koha Ditore”, 10 korrik 2012, e martë, fq. 2;
- Letër e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. ref.: 63/151 e datës 16 mars 2015, drejtuar Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës;
- Letra e Shefes së Misionit EULEX, znj. Alexandra Papadapoulou, e datës 4 maj 2017,Reference:2017-COS- 0294;
- Maria Lúcia Amaral, “Judicial activism of European Constitutional Courts: does it really exist?”, a paper presented at the international conference organized by the Constitutional Court of the Republic of Latvia in cooperation with European Commission for Democracy through law (Venice Commission) (26-27 May 2016, Riga), fq. 337-341 në fq. 339. Në internet: http://www.satv.tiesa.gov.lv/en/wp-content/uploads/sites/2/2017/06/ BookJudicial-activism-of-the-Constitutional-Court-in-a-Democratic State_ part _1 ENG.pdf;
- *Marrëveshja ia njeh pushtetin kushtetutbërës Asociacionit*, botuar në të përditshmen kosovare ZËRI DITOR, më 4 nëntor 2015;
- Mathieu Disant, “Les effets dans le temps des décisions QPC”. *NOUVEAUX CAHIERS DU CONSEIL CONSTITUTIONNEL* N° 40 (DOSSIER: LE CONSEIL CONSTITUTIONNEL: TROIS ANS DE QPC) - JUIN 2013. Në internet: https://www.conseil-constitutionnel.fr/

node/1786/pdf (shikuar më 31 korrik 2019);

- Mendim i Përbashkët Mospajtues i gjyqtarit Almiro Rodrigues dhe gjyqtares Snezhana Botusharova: *Rasti Nr. KI 47/10 Naim Rrustemi dhe 31 Deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kundër Shkëlqesisë* së Tij, Fatmir Sejdiu, President i Republikës së Kosovës (12 tetor 2010);
- Mendim Mospajtues. Almiro Rodrigues. Rasti KI 11/09. Tomë Krasniqi vs. RTK ("Radio Televizioni Kosovës") dhe KEK ("Korporata Energjetike e Kosovës"). Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Nr. Protok. 116/09. Prishtinë, më 20 tetor 2009; Mendim Mospajtues. Gjyljeta Mushkolaj. Rasti KI 11/09. Tomë Krasniqi vs. RTK ("Radio Televizioni Kosovës") dhe KEK ("Korporata Energjetike e Kosovës"). Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Nr. Protok. 141/09. Prishtinë, më 23 tetor 2009;
- Mr Igor SPIROVSKI, "*THE COMPETENCE OF THE CONSTITUTIONAL COURT TO CONTROL THE CONFORMITY OF LAWS WITH INTERNATIONAL TREATIES: NEW TRENDS IN CONSTITUTIONAL JUSTICE*". EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION) in co-operation with THE CONSTITUTIONAL COURT OF MONTENEGRO AND THE OSCE. (Report). CDL-JU(2009) 036 (Engl. only). Strasbourg, 17 November 2009;
- Ms Eliška Wagnerova, "The Effects of the Decisions of the Constitutional Court in Relation to Other Jurisdictions". European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Conference on the Role of the Constitutional court in the Maintenance of the Stability and Development of the Constitution*. Strasbourg, 19 February 2004. CDL – JU (2004) 017. Në internet:https://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-JU(2004)017-e (shikuar në mars 2018);
- No judge shall hear or determine an appeal from the decision of a case or issue tried by him. (June 25, 1948, ch. 646, 62 Stat. 872.). Në internet: https://www.law.cornell.edu/uscode/text/28/47 (shikuar në prill 2018);
- No. 18232 MULTILATERAL *Vienna Convention on the Law of Treaties* (With Annex). Concluded at Vienna on 23 May 1969. Authentic texts: English, French, Chinese, Russian and Spanish. Registered ex officio on 27 January 1980. Në internet: https://treaties.un.org/doc/publication/unts/volume%201155/volume-1155-i-18232-english.pdf (shikuar në mars 2018);
- Olivera Vucic, *Austrijsko ustavno sudstvo – čuvar federacije i ustava* (mbrojtur më 1995 në Fakultetin Juridik të Universitetit të Beogradit);
- Patrizia Pederzoli, "I GIUDICI DELLA CORTE COSTITUZIONALE"*dis CRIMEN articoli*, 23.11.2018. Në internet: https://discrimen.it/wp-content/uploads/Pederzoli-I-giudici-della-Corte-costituzio n ale.pdf (shikuar më 21 qershor 2019);
- *POSLOVNIK USTAVNOG SUDA REPUBLIKE HRVATSKE* (pročišćeni tekst). Broj: SuT-A-6/2014 Zagreb, 26. svibnja 2014. Në internet: https://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/ 2014_07_83 _ 1623. html (shikuar në prill 2018);
- Presidente e plotë, gazeta e përditshme "Express", 7 korrik 2012, e shtunë, fq. 1 dhe 4-5;
- Presidentja "mes dy zjarresh", ZËRI (23 qershor 2014), (shikuar në shkurt 2020);
- Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, 2 shkurt 2007. Në internet:https://reliefweb.int/report/serbia/comprehensive-proposal-kosovo-status-settlement-s2007168 add1 (shikuar në shkurt 2019);
- Rambouillet Accords: Interim Agreement for Peace and Self-Government in Kosovo. *Letter dated 4 June 1999 from the Permanent Representative of\france to the United Nations Addressed to the Secretary General.* Security Council S/1999/648. 7 June 1999;
- Raporti i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (Dokumenti 12462), i 7 janarit

2011;

- REPUBLIQUE ALGERIENNE DEMOCRATIQUE ET POPULAIRE: PRESIDENCE DE LA REPUBLIQUE.SECRETARIAT GENERAL DU GOUVERNEMENT, *CONSTITUTION DE LA REPUBLIQUE ALGERIENNE DEMOCRATIQUE ET POPULAIRE* (Mars 2016). Në internet: http://www.joradp.dz/TRV/FCons.pdf (shikuar në korrik 2017);
- Sanita Osipova, "A State Governed by the Rule of law or "a Judges' State"?", a paper presented at the international conference organized by the Constitutional Court of the Republic of Latvia in cooperation with European Commission for Democracy through law (Venice Commission) (26-27 May 2016, Riga), fq. 304-314 në fq. 307-308. Në internet: http://www.satv.tiesa.gov.lv/en/wp-content/uploads/sites/2/2017/06/ BookJudicial-activism-of-the-Constitutional-Court-in-a-Democratic State_ part _1 ENG.pdf (shikuar në shkurt 2019);
- Sanjeev Anand, "The Truth About Canadian Judicial Activism" *Constitutional Forum* Vol. 15 No. 2 (2006);
- Security Council, *Letter dated 6 August 2004 from the Secretary-General addressed to the President of the Security Council.* S/2004/932. Distr.: General 30 November 2004;
- Security Council, *Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo.* S/2004/613. Distr.: General 30 July 2004;
- Sentencia del Tribunal Constitucional 51/2011 në rastin Moore v President of the Methodist Conference, botuar në Oxford Journal of Law and Religion Vol. 1 Issue 1 (2012);
- *Serbian Academy of Arts and Sciences (SANU) Memorandum 1986*;
- Siegfried Bross, "Reflections on the Execution of Constitutional Court Decisions in a Democratic State under the Rule of Law on the Basis of the Constitutional Law Situation in the Federal Republic of Germany"(Report). Në European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Conference on "Execution of the Decisions of Constitutional Cou`rts: A Cornerstone of the Process of Implementation of Constitutional Justice"on the Occasion of the 10th Anniversary of the Constitutional Court of Azerbaijan,* Baku, Azerbaijan 14-15 July 2008. CDL-JU(2009)001. Strasbourg, 27 January 2009. Engl. Only. Në internet: https://www.venice.coe. int/webforms/documents /default.aspx?pdffile=CDL-JU(2009)001-e (shikuar më 1 korrik 2019);
- *Službeni list SRCG*, broj 1/63, Odluka o proglašenju Ustava SRCG, broj 329/1 od 10. aprila 1963. Godine;
- Sokol Bylykbashi, "Kushtetuesja politike", gazeta e përditshme "Tribuna Shqiptare", 19 gusht 2012, e mërkurë, fq. 13;
- Tribuna shqiptare, e premte, 2 mars 2012:"Fusnota, zor të dërgohet në Kushtetuese!"fq. 5;
- Tribuna, 10 shtator 2014:"Jahjaga, keq me Kushtetutën!"fq. 1 & 3;
- Tribuna, 16 korrik 2014:"Fol presidente" fq. 1 & 4-5;
- Tribuna, e diel, 13 prill 2014:"Tranzicioni antikushtetues", fq. 1 & 4-5;
- Tribuna, e hënë, 29 shtator 2014:"Zhbllokohet Kushtetuesja", fq. 4;
- Tribuna, e hënë, 29 shtator 2014:"Zhbllokohet Kushtetuesja", fq. 4;
- Tribuna, e martë, 16 shtator 2014:"Gjykatësi i ri zgjidhet shpejt", fq. 3;
- Tribuna, e martë, 16 shtator 2014:"Ideja e Krasniqit", fq. 5;
- Tribuna, e mërkurë, 3 shtator 2014:"Presidentja mbi Kushtetutën për ndërkombëtarët" fq. 1 & 3;
- The Constitutional Court of Croatia. *Decision U-I-3789/2003 et al*. Narodne Novine 142/10. Identification: CRO-2010-3-016. Botuar në European Commission for Democracy through Law (Venice Commission), *The Bulletin* (Strasbourg, October 2011);
- The General Framework Agreement for Peace in Bosnia and Herzegovina (1995). Në internet: https://www. osce.org/bih/126173?doënload=true (shikuar në mars 2017);
- Ustav Republike Hrvatske. *NARDNE NOVINE*, Br. 56 od 22 Decembera 1990. Amendamentet janë publikuar në *NARODNE NOVINE* Nr.: 135/97 (8/98 – teksti i konsoliduar),

113/2000 (124/2000 – teksti i konsoliduar) dhe 28/2001 (41/2001 – teksti i konsoliduar, 55/2001 - korrektim);

- Ustavna povelja drzavne zajednice Srbija I Crna Gora (4 februar 2003);
- Ustavna povelja Srbije i Crne Gore, *Međunarodna politika*, Dokumenti, Beograd, br. 1108, 2002;
- Vendim i Bordit për Ankesa Ref. 1503/213/BA/dk i datës 3 mars 2015. Republika e Kosovës. Komisioni i Pavarur i Mediave. Në internet: http://www.kpm-ks.org/materiale/dokument/ 1426689009.8373.pdf (shikuar në korrik 2019);
- *Viewing cable 10 Prishtina 84. U.S. Embassy in Pristina. Subject: Kosovo Celebrates Second Anniversary with Sucess and Challenges. Date: 2010-02-17.* (seksioni me titull"Importance of the Rule of Law"). Në internet: http://wikileakscablegate. blogspot. com/2010 /12/vieëing-cable-10pristina84-kosovo.html (shikuar në janar 2019);
- *Visit to the Judicial Yuan, Taipei, 10 November 2015. Presentation by Mr Schnutz Dürr.* Në internet: https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-JU-PV(2015)003-e (shikuar në prill 2018);
- Vlaudia Maria Barbosa, "The Brasilian Supreme Court: Between Activism and Judicial Responsibility". I-CONET (December 25, 2012) Në internet: http://www.iconnectblog.com 2012/12/the-brazilian-supreme-court-Between-activism-and-judicialresponsibility/;
- Zëri, 11 prill 2015: "Fundi i "Babës" në Kushtetuese" fq. 1 & 7;
- Zëri, 11 shkurt 2015: "Kushtetuesja kërkon 'nëntëshin'", fq. 6;
- Zëri, 16 mars 2015: "Fundi i Hasanit në Kushtetuese" fq. 1 & 5;
- Zëri, 16 qershor 2014: "Enver Hasani shkel ligjin" fq. 1 & 2;
- Zëri, e diel, 17 prill 2016: "Vendimet 'kundërthënëse' të Kushtetueses", fq. 6;
- Zëri, e diel, 3 gusht 2014: "Mushkolaj: S'ka kthim në pikën zero", fq. 4 & 5;
- Zëri, e diel/e hënë, 27-28 korrik 2014: "Baballarët" e Kosovës" fq. 1 & 2-3;
- Zëri, e hënë, 29 shtator 2014: "Nga 1 tetori kthehet gjyqtari Carolan", fq. 2;
- Zëri, e hënë, 29 shtator 2014: "Nga 1 tetori kthehet gjyqtari Carolan", fq. 2;
- Zëri, e hënë, 7 prill 2014: "Pushtetarët shkelin Kushtetutën", fq. 4-5;
- Zëri, e martë, 16 shtator 2014: "Ikë gjyqtari i dëshpëruar amerikan", fq. 1 & 7;
- Zëri, e mërkurë, 17 shtator 2014: "Gjyqtari e vë në siklet EULEX-in", fq. 1-2);
- Zëri, e mërkurë, 17 shtator 2014: "Carolan, amerikani i dytë që ikë nga Kosova", fq. 3;
- Zëri, e premte, 25 shtator 2015: "Kosova urgjentisht të aplikojë në Këshillin e Evropës", fq. 8-9;
- Zëri, e shtunë, 13 qershor 2015: "Enver Hasani edhe dy javë në Kushtetuese", fq. 1 & 6;
- Zgjedhjet e parakohshme presidenciale varen nga Jahjaga, gazeta e përditshme "Koha Ditore", 7 korrik 2012, e shtunë, fq. 1 dhe 3.;

TREGUESI:

A

a posteriori 88, 92, 93, 94, 98, 103, 173, 174, 213, 475
a priori 88, 545, 747, 831
abdikimi 655, 656, 672
Abdylhamiti (shih *Sulltan Abdylhamiti II*)
Abhazia 138
ablativ 173, 188, 741, 743, 782, 783
aborti 654, 655, 672, 684, 686, 768
aborti anencefalik 685
absolut 38, 40, 44, 49, 50, 71, 106, 131, 194, 195, 202, 204, 259, 268, 308, 311, 364, 375, 469, 532, 533, 534, 540, 541, 542, 547, 549, 552, 553, 682, 699, 709, 717, 745, 823, 885
absorbuar 207, 454, 550
abstenimi 651, 672
abstrakti 44, 87, 88, 92, 93, 94, 100, 103, 111, 122, 132, 144, 152, 155, 156, 163, 164, 165, 166, 177, 184, 188, 206, 227, 235, 244, 245, 248, 250, 252, 257, 258, 268, 269, 275, 276, 280, 281, 388, 390, 391, 392, 393, 394, 395, 400, 401, 402, 405, 415, 418, 419, 420, 421, 422, 423, 424, 425, 439, 440, 449, 455, 456, 458, 462, 465, 466, 467, 468, 469, 475, 476, 478, 479, 482, 490, 491, 493, 590, 600, 610, 613, 623, 624, 625, 628, 630, 638, 639, 640, 648, 649, 664, 668, 669, 670, 672, 684, 686, 692, 694, 701, 703, 705, 707, 709, 710, 711, 713, 714, 716, 718, 723, 727, 728, 730, 731, 732, 734, 745, 746, 748, 749, 773, 778, 779, 781, 787, 818, 841, 843
acquis communautaire 691
actio popularis 50, 63, 64, 65, 75, 80, 126, 174, 175, 180, 184, 188, 189, 258, 282, 387, 414, 422, 424, 425, 455, 482, 605, 691, 794, 813
ad hoc 74, 95, 267, 283, 373, 429, 510, 541, 648, 699, 776, 787
ad hominem 383, 384, 468, 475
ad literam 133, 256, 278, 467, 499, 504, 505, 506, 600, 602, 851, 862
ad memoaret 499
Adalet ve Kalkınma Partisi 225
administrativo-teknike 537, 541
Adolf Hitler 48, 70, 431, 689
Adriatik Kelmendi 466
Advisory Opinion 394, 395, 396, 473, 797, 804, 896, 905, 906, 909, 918, 919, 922, 924, 947
Afganistani 134, 221
Afrika 78, 274, 275, 276, 279, 293, 465, 502, 596
Afrika e Jugut viii, 78, 219, 271, 273, 278, 279, 290, 335, 461, 465, 475, 516, 682
Afrika e Veriut 590
Afrika Perëndimore 274, 275
Aharon Barak 233, 238, 764, 765, 903
Aizawa v Japan 270
Ajatollah Homeini 202
akademikët 386, 515, 523, 594, 753, 854
Akdivar et al v. Turkey 452
Aktakuza 560
aktgjykimet interpretative 741
aktgjykimet kërcënuese 751
aktgjykimet manipulative 741
aktgjykimet meritore 766, 852
aktgjykimi 133, 149, 292, 356, 369, 408, 430, 448, 454, 457, 459, 535, 536, 537, 553, 556, 573, 589, 590, 647, 657, 660, 662, 665, 676, 704, 706, 719, 722, 732, 756, 768, 776, 784, 791, 792, 793, 817, 826, 827, 830, 832, 837, 843, 863, 883
Akti Final i Helsinkut 334
akti juridik 23, 37, 93, 164, 168, 169, 170, 172, 185, 241, 244, 291, 297, 340, 392, 394, 396, 425, 440, 441, 442, 454, 455, 501, 526, 636, 664, 668, 673, 747, 751, 761, 776, 782, 787, 813, 831, 844, 856
Akti themelues i datës 1 dhjetor 1918 308
aktiv 71, 129, 140, 235, 293, 297, 384, 403, 453, 460, 520, 522, 609, 619, 620, 652, 659, 662, 663, 678, 684, 686, 700, 721, 807, 808, 835
aktivizmi gjyqësor 146, 392, 572, 617, 618, 619, 620, 621, 622, 623, 625, 626, 629, 631, 632, 633, 636, 640, 641, 644, 651, 652, 654, 656, 657, 661, 662, 668, 669, 671, 676, 682, 685, 691, 694, 697, 699, 700, 701, 702, 703, 704, 705, 706, 707, 739, 753, 830
aktvendimi 454, 458, 536, 589, 590, 609,

657, 658, 660, 661, 676, 704, 706, 719, 721, 722, 726, 732, 773, 777, 787, 791, 792, 793, 812, 829, 830, 836, 837, 884
aktvendimi për papranueshmëri 660, 793
Albania 143, 151, 153, 292, 554, 797, 799, 952, 953
Albin Kurti 435, 809, 810
Aleks de Tokvil 62, 80, 617
Aleksandar Karagjorgjeviq 308
Aleksandar Rankoviq 320
Aleksander Hamilton 53, 617
Aleksandër Lumezi 543, 567, 568, 678
Alex N. Dragnich 310, 311, 891
Alexandra Papadapoulou 560, 956
Algjeria viii, 76, 78, 193, 204, 205, 207, 210, 285, 502
Allgemeine Staatslehre 66
Alltay Surroi 527
Almiro Rodrigez 502
Alparslan Altan 564
amendamentet antikushtetuese 473
amendamentet e pandryshueshme kushtetuese 640
amendamentet IX-XC 323
amendamentet jokushtetuese 364, 418, 471, 626
amendamentet kushtetuese federale 315
amendamentet kushtetuese jokushtetuese 464, 465, 474, 475
amendamenti kushtetues 58, 256, 372, 393, 475, 476, 480, 488, 502, 647, 648, 662, 778
amendamenti kushtetues nr. 24 - 411, 413
Amerika 33, 45, 54, 55, 62, 80, 83, 84, 422, 465, 596, 675
Amerika e Veriut 54, 79
Amerika Latine vii, 54, 56, 65, 89, 161, 163, 422, 465, 596, 675
amerikane xiii, 24, 25, 33, 39, 45, 46, 47, 51, 56, 59, 60, 61, 62, 68, 81, 83, 84, 85, 90, 91, 102, 121, 161, 162, 163, 165, 171, 177, 182, 187, 289, 329, 395, 396, 417, 541, 542, 551, 552, 564, 567, 575, 641, 642, 649, 651, 686, 687, 694, 772, 842
amicus curiae 289, 291, 292, 297
amparo 25, 47, 51, 62, 75, 81, 165, 168, 171, 174, 176, 177, 178, 181, 188, 189, 490, 698, 708, 752
amparo como contencioso-administrativo 62
amparo contra leyes 47, 51, 62
amparo de libertad 62
amparo en materia agraria 62
Amuur v. France 453, 931
analiza apo testi i proporcionalitetit 762, 785
analiza profesionale 384
analogjia 256, 325, 741, 753, 817, 855
Anchugov & Glatkov kundër Rusisë 150, 160
ancien regime 40, 41, 386, 579, 789
aneksi kushtetues 227
Anglia 44
anglofon 274, 276
Angola 335, 502, 503
Ankara 226, 453, 904, 909
ankesa individuale 228
ankesa jo e plotë kushtetuese 244, 482
ankesa kushtetuese ix, 50, 116, 136, 140, 158, 228, 241, 252, 280, 281, 282, 400, 401, 403, 449, 456, 672, 713
ankesa kushtetuese kosovare 280
antidota 382
Antika 34
Antonio de Oliveira Salazar: 1889-1970 73
anulimi 145, 177, 236, 237, 262, 282, 316, 543, 545, 666, 699, 705, 715, 728, 729, 730, 733, 736, 737, 739, 741, 743, 744, 745, 746, 747, 748, 751, 763, 766, 782, 827, 834, 862, 875
anulimi i pjesshëm 739, 740
anulimi i pjesshëm kualitativ 739
Anvar al Sadat 198
Apartheidi 335, 462, 683, 706, 912
Apiko 834
apostazia 255
apriori 173, 432, 481, 518
arabe vii, 54, 65, 72, 75, 76, 77, 78, 81, 106, 134, 192, 194, 195, 196, 197, 198, 204, 209, 210, 212, 215, 229, 230, 289
Arabia Saudite 196
Arava 230

arbitrare 224, 238, 243, 256, 358, 478, 537, 543, 544, 551, 552, 564, 565, 573, 605, 645, 646, 647, 660, 667, 668, 677, 682, 705, 768, 779, 792, 809, 814, 815, 816, 817, 818, 844, 857, 868, 872, 873, 874, 880, 887
Ardian Klosi 558, 894
Argjentina 47, 164, 165, 166, 170, 518, 540, 559
argumenti dialogues 766, 786
argumenti i paraqitur nga parashtruesi 505
argumenti këmbët e karriges 753, 756, 854
argumenti konspirativ 838
argumenti me një rresht 756, 757, 784
argumenti me strukturë dialoguese 757, 784
argumenti me strukturë paralele 771
argumentum a contrario 454, 733
Arijeta Halimi 724
aristokracia e togës 69
Aristoteli 368
Arkivi i Gjykatës Kushtetuese 496
Armata Jugosllave 382
Armenia 134, 293, 559, 562, 774, 779, 904
Aron Barak 238
Arsim Bajrami 467, 722, 956
Arta Rama-Hajrizi 511
Arthur M. Schlesinger Jr 622
Asambleja xv, 36, 63, 142, 203, 204, 205, 223, 224, 226, 231, 288, 293, 294, 297, 347, 409, 516, 558, 564, 692, 821
Asambleja e Kretës 36
Asambleja e Madhe e Turqisë 224
Asambleja e Madhe Nacionale 226, 227, 228
Asambleja e Përfaqësuesve të Popullit 213
Asambleja e Përgjithshme e OKB 564, 821
Asambleja Konsultative Islamike 203
Asambleja Kushtetuese e Izraelit 231
Asambleja Kushtetuese e Rumanisë 142
Asambleja Parlamentare xv, 288, 293, 347
Asociacioni x, 398, 441, 442, 479, 632, 636, 638, 702, 757, 772, 784, 791, 818, 819, 821, 822, 831, 838, 884, 956
Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe 791
Ataturku 224
Athina 35, 36, 37
Atifete Jahjaga 399, 441, 463, 465, 466, 467, 497, 498, 502, 508, 543, 595, 632, 635, 636, 637, 778, 800, 801, 802, 821, 829, 831, 836, 838, 883, 884, 886, 930, 943
Atlantiku xviii, 26, 28, 44, 56, 61, 83, 87, 101, 102, 229, 311, 411, 444, 459, 535, 540, 542, 545, 548, 556, 559, 567, 594, 617, 626, 653, 703, 713, 749, 842, 849
atribucioni 174
auditimi 226, 259, 274
Auditori i Përgjithshëm 553
Augusto Pinochet 75
Australia 50, 396, 516, 523, 530, 594, 682, 683, 745, 754, 906, 907, 913, 920
Austria 47, 48, 49, 56, 58, 122, 127, 128, 272, 286, 326, 388, 453, 485, 486, 490, 509, 514, 515, 518, 532, 559, 562, 682, 684, 692, 727, 741, 755, 774, 866, 867, 868, 871, 875, 876, 879, 882, 893, 904, 912, 931, 933, 934
Austro-Hungaria 326
auto-saisine 277
automatike 120, 267, 452, 497, 564, 768, 799
autonomia politiko-territoriale 312
autonomia substanciale e Kosovës dhe Metohisë 348
autorët 27, 38, 67, 108, 112, 113, 165, 177, 226, 227, 277, 353, 366, 372, 383, 392, 411, 424, 461, 466, 472, 474, 487, 505, 534, 541, 546, 564, 568, 580, 588, 594, 627, 692, 722, 723, 743, 749, 774, 783, 793, 831, 832
autoriteti emërues 493
autorizimi ablativ 173, 188
Avogadori del Commun 37
Avokati i Popullit 99, 288, 372, 398, 412, 422, 424, 480, 495, 504, 505, 506, 507, 510, 511, 522, 530, 545, 548, 553, 555, 592, 595, 596, 644, 645, 665, 675, 811, 839, 937, 942, 943, 944
Azerbajxhani 239, 240, 280, 293
Azia 78, 422, 465, 675
Azia Jug-Lindore 221, 675
Azia Lindore 251
Azia Perëndimore 239
Azia Qendrore 422

B

Bahreini 195
Bajrush Gashi 630, 938
Bangladeshi 326
Banka Qendrore 512
Banka Rajfajsen 812
Banković and others v. Belgium and others 591, 933
Banovina 310
Banovina e Kroacisë 310
barazia gjinore 295, 519, 638, 703, 736, 750
Barbadosi 185, 187, 944
Baronesha Katherin Ashton 506
bashkësia e bindjeve të përbashkëta 739
Bashkësia Islame e Kosovës 408
Bashkimi Ekonomik Evropian 695
Bashkimi Evropian xv, 101, 285, 349, 481
Bashkimi Sovjetik 107, 205, 241, 242, 245, 247, 255, 307, 639
bazat e diskriminimit 739
Behgjet Pacolli 496, 742, 791, 798, 800
Bekim Sejdiu 442, 508, 557
Belgjika 286, 490, 503, 518, 532, 562, 590, 727, 744, 745
Beliza 186
Benini 275, 277, 502
Benito Musloni 48
Benjamin Konstan 62, 71
Beogradi 39, 67, 70, 108, 112, 116, 117, 118, 119, 120, 125, 158, 301, 308, 309, 313, 318, 323, 352, 376, 378, 459, 483, 639, 804, 820, 824, 892, 896, 897, 898, 899, 900, 901, 915, 921, 923, 925, 949
Bergman v Minister of Finance 233
Berlini 77, 131, 274, 288, 302, 312, 625
Betlehemi 229
Bislimi v. Ministria e Brendshme 454
Bjellorusia 77, 134, 136
blloku i kushtetutshmërisë 43, 44, 51, 400
bloc de constituionalite 400, 610
Bolivia 59, 60, 61, 64, 74, 78, 79, 164, 168, 172, 181, 183, 184, 189, 502, 642, 905, 931
Bolivia, Uruguai 64
bona fide 150, 345, 350, 437, 506, 824, 825
Bonham 21, 24, 34, 39, 40, 44, 83, 549, 552, 553, 575, 626, 694, 701
Bordi i Mjekëve të Kolegjit Mbretëror 549
Boris Ebzeev 444, 916
Boris Jelcin 50, 145, 146, 147
Bosnjë-Hercegovina 293, 294
Bota e Tretë 366
Bota sot 384, 385, 948
bouche de la loi 40, 363, 579, 581, 686, 852
boule 36
Bradley v. Fisher 541, 945
Brazili 50, 59, 60, 79, 164, 165, 172, 173, 285, 503, 682, 745
Bregu Perëndimor 229, 230
BREXIT 101, 695
Britania e Madhe 23, 34, 39, 696, 771, 825
Brittney Kern 541, 906
Brukseli 354, 356, 369, 399, 441, 442, 819, 824
Budizmi 256
Bujar Bukoshi 327
Buletin 289, 290
Buletin on Constitutional Case-Law 289
Bullgaria 77, 134, 293, 469, 502, 509, 518, 559, 562, 592, 596, 827, 830, 841
Bundesrati 465
Bundestagu 736
Burboni 686
burime metafizike kuranore 191
burimi formal i së drejtës 570, 573, 579, 580, 582, 588, 592, 613
burimi i butë 590, 592, 613, 677
Burkina Faso 275, 277, 502
Burundi 78, 277
Buxheti i Konsoliduar i Kosovës 531
Byroja për Legjislacion e Kabinetit 269

C / Ç

Çadi 277, 502
caktimi i drejtpërdrejtë 494, 509
Calamandrei 580
Camp David 229

caqet kohore të aktit mbi shpalljen 434
caqet objektive 718
Carl Schmitt 26, 36, 48, 53, 67, 70, 71, 91, 352, 356, 428, 438, 459, 628, 804, 893, 897, 901, 902, 915
case and controversy 85, 457
Çasllav Millosh 105
Çekia 130, 132, 159, 401, 502, 518, 592, 682, 745, 747, 775
Çekosllovakia 49, 56, 57, 67, 72, 80, 107, 131, 151, 309, 385; shih dhe *Federata e Çekosllovakisë*
centralizmi demokratik socialist 261
centralizuar viii, 26, 27, 30, 44, 48, 59, 60, 61, 63, 65, 66, 74, 75, 77, 78, 88, 89, 90, 91, 92, 97, 99, 162, 164, 165, 172, 174, 175, 177, 178, 181, 183, 184, 185, 188, 189, 219, 242, 243, 252, 264, 265, 268, 270, 271, 274, 276, 277, 307, 308, 309, 323, 395, 415, 422, 457, 720
certiorari 86, 87, 173, 479, 651
çështja kushtetuese 69, 86, 87, 88, 98, 102, 114, 136, 153, 165, 172, 174, 175, 176, 177, 180, 181, 188, 250, 254, 255, 273, 281, 283, 291, 396, 398, 399, 412, 427, 441, 457, 464, 486, 491, 534, 574, 595, 609, 625, 632, 634, 636, 651, 660, 661, 662, 671, 719, 807, 808, 809, 814, 829, 831, 837, 838, 839, 848, 884, 888
çështja paraprake e kushtetutshmërisë 456, 482, 688
çështjet e të drejtave dhe lirive zgjedhore 847
çështjet fetare 408, 847
Charles de Gaule 515, 687
Charles Eisenmann 627, 893
charter 83
Ciceroni 38
civil 37, 41, 56, 75, 90, 148, 161, 162, 163, 165, 169, 170, 171, 172, 186, 187, 193, 201, 202, 227, 229, 253, 254, 263, 334, 339, 349, 383, 386, 434, 487, 491, 492, 532, 533, 534, 541, 542, 548, 550, 564, 569, 573, 574, 579, 580, 581, 582, 583, 584, 588, 598, 599, 612, 658, 706, 716, 720, 727, 735, 766, 775, 812, 855, 856, 862, 863, 871, 925
Claudio Pala 558
Codex 578
CODICES xv, 289, 290, 291, 297, 520, 955
common contitutional heritage 590
common law 21, 24, 25, 29, 39, 40, 59, 60, 61, 83, 162, 163, 169, 187, 219, 289, 399, 491, 549, 563, 564, 565, 569, 618, 720, 825, 873
condictio sine qua non 527
constituent power 399
constitution-conform interpretation 664, 669, 670, 671, 704, 705
Constitutional Court Judgment 768, 769, 932
constitutional interpretation 389, 423, 712
constitutional review 104, 225, 227, 423, 926, 927
constitutiones 577
controle prioritaire de constitutionalite 142
cordone sanitaire 307, 309
Corpus Iuris Civil 577
Costantino Mortati 692
Council of Revision 86
Csongor Kuti 358, 748, 803, 893

D / Dh

D. H. et al. v. The Czech Republic 452, 933
Dastid Pallasaka 384
David A. Strauss 640, 905
de facto 113, 194, 322, 323, 327, 357, 358, 360, 376, 426, 518, 573, 579, 580, 583, 612, 804, 805, 820
De iudicibus 882
de jure 323, 359, 376, 820
debati Kelsen–Shmit 80, 444
Deçani 658, 834, 835
declarations of voidness 746
deference 664, 668, 670, 704, 705
Dega e Posaçme xv, 316
Dega e Posaçme Kushtetuese 316
Dega Kushtetuese 316
Dejtoni 113, 329
Deklarata e Korfuzit 307
Deklarata e Moskës 311
deklarata e mospërputhshmërisë 695

Deklarata e Pavarësisë 231, 321, 339, 350, 351, 352, 353, 355, 356, 360, 473, 585, 629, 630, 772
Deklarata e Pavarësisë së Kosovës 321
Deklarata e Rios 592
Deklarata Harari 231, 233, 279
Deklarata Kushtetuese 328
Deklarata mbi Pavarësinë, 373
Deklarata mbi shpalljen e RFPJ 303, 313
deklarativi 169, 173, 503, 545, 658, 691, 695, 711, 800, 868, 875, 880
dekreti 144, 146, 210, 216, 243, 309, 310, 415, 424, 425, 426, 434, 480, 507, 544, 553, 644, 743, 799, 821, 827, 884
Dekreti i sfiduar 544
Dekreti mbi Banovinën e Kroacisë 310
Dekreti mbi ndarjen vendit në rrethe 308
Dekreti nr. 87 – 1415 210, 216
dekretimi 501, 526, 808
Delegacioni i Kosovës 332
Delegacioni serb 332
demokracia konsociacionale 850
demokracia kristiane 693
demokracia kushtetuese konsociacionale 807
demokracia në Amerikë 62, 80
demokratike xviii, xix, 49, 288, 293, 294, 297, 301, 303, 313, 327, 379, 398, 520, 522, 523, 631, 633, 712, 794, 798, 800, 806, 829, 884, 930, 940, 944
deni de justice 672, 676, 849, 881
dënimi 230, 542, 562, 630, 654, 686, 875, 877
dënimi me vdekje 654
Departamenti Administrativ 492
deportimi i shtetasve të huaj 604
Der Huter Der Verfassun 67
derivativ ix, 27, 352, 353, 449, 451, 456, 493, 618, 627, 628, 629, 631, 638, 641, 643, 650, 701, 702, 859
derogimi 430, 647
devolved powers 707, 708
Dhjata e Re 549
Dhjata e Vjetër 549
Dhoma e Censorëve 61, 162
Dhoma e Deputetëve 173, 223
Dhoma e Kornizës 344
Dhoma e Lordëve 95, 396, 582, 695
Dhoma e Përfaqësuesve 61, 129, 559
Dhoma e Popujve 313
Dhoma e Posaçme 407, 802, 803, 804, 805, 834, 835, 886
Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës 357, 596, 597, 665, 802, 833, 938, 939, 942
Dhoma e Senatorëve 161, 162
Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese 409 ,410, 413
Dhoma e Specializuar Kushtetuese 412
Dhoma e Tribunëve 162
Dhoma Federative 313
Dhoma Kushtetuese 99, 412, 414
Dhoma për Kontrollin e Kushtetutshmërisë 99
dialoguese/diskursive 770
Diana Kastrati 718
Diet 268, 269
diktatura 48, 91, 107, 151, 211, 248, 261, 278, 309, 436, 691
diktatura popullore 261, 264
dilema kundermazhoritare 444
Dimitry Medvedev 147
Dinastia Chin 259
Dinastia Han 259, 282
Dinastia Qing 259
diritto vivente 641, 642, 643, 669, 692, 702, 703, 740, 741, 743, 782, 783, 905, 918, 923
disposizione 641, 642, 669, 740, 782
dispozitat e paamendamentueshme kushtetuese 689
dispozitat e rrënjosura 474
dispozitat e rrënjosura në mënyrë absolute 465
dispozitat kushtetuese 349, 491, 851
dispozitat kushtetuese që nuk mund të ndryshohen 465
dizajni institucional 256, 620, 625
doktrina e precedentit 754

doktrina e rendit objektiv juridik 689
doktrina franceze 670
doktrina gjermane 464
doktrina kosovare mbi amendamentet jo kushtetuese 418
dokumenti i gjallë 472, 640, 641, 643, 694, 702, 703
Dollfus 49
Dominique Chagnollaud 30
Dorit Beinish 238
Douglas MacArthur 49
Dr. Aaron Bergman 233
Dr. Bonham 21, 24, 34, 39, 40, 44, 83, 549, 552, 553, 575, 626, 694, 701
Dr. Ibrahim Rugova 327, 329
drejta civile 77, 162, 169, 197, 270, 278, 383, 530, 571, 573, 580, 581, 583, 599, 611, 683, 720, 721
drejta civile-kontinentale 530
drejta e butë 611, 615, 591
drejta e fortë 611, 615
drejta e gjallë 668, 705
drejta e huaj 368, 591, 597, 599, 603, 713, 753, 754
drejta e krijuar nga gjykata 622
drejta e martesës në mes të sekseve të njëjta 654
drejta e përgjithshme xv, 24, 39, 40, 44, 83, 618, 622, 626, 683, 754
drejta e precedentëve 573
drejta e Sheriatit 191, 197, 199, 215
drejta e shkruar 573, 706
drejta italiane 732
drejta kolektive 446
e drejta kushtetuese 23, 28, 29, 63, 67, 77, 84, 108, 113, 125, 149, 229, 236, 285, 288, 291, 296, 297, 301, 302, 310, 336, 338, 340, 352, 362, 364, 372, 373, 444, 459, 464, 516, 535, 570, 580, 582, 584, 586, 587, 593, 594, 598, 618, 623, 624, 634, 640, 647, 683, 687, 693, 702, 706, 707, 716, 717, 718, 762, 765, 772, 776, 785, 834, 848, 852, 860, 862, 868, 881, 884
drejta kushtetuese komparative 660, 687, 701
drejta kushtetuese materiale 624, 634, 647
drejta natyrore 38, 55, 237, 582, 811
drejta ndërkombëtare kontraktuale 438, 498, 504, 506, 695
drejta ndërkombëtare zakonore 213, 374, 434, 541, 559, 699, 824, 885
drejta në pension invalidor të kategorisë së dytë 861
drejta në pronë 861
drejta zakonore ndërkombëtare 442, 499, 506, 588, 824, 826, 885
Drejta Zgjedhore dhe Pakicat Kombëtare 295
drejtave dhe lirive themelore 22, 114, 127, 239, 288, 369, 429, 452, 771, 851, 880
drejtimi prospektiv 630
drejtimi retrospektiv 630
Drenica I 793
Drini i Bardhë 112
Duka 37
Dukagjini 112
Durmitori 322
Dy traktate mbi qeverisjen 38
Dzenana Hadjiomerovic 496

E

echte 450
Edeni 366
edikte 575, 612
Edvard Koke 24, 39, 40, 83
efekt juridik konstituiv 714
efekt konstitutiv 714
efekt të përgjithshëm juridik 601, 609
efektet horizontale 610
efektet indirekte horizontale 762, 785
efektet juridike 93, 123, 499, 570, 636, 651, 711, 714, 716, 717, 720, 728, 730, 731, 746, 752, 776
efektet juridike të vendimeve 123, 570, 651, 714, 716, 717, 730, 731
efektet vertikale 610
efekti erga omnes 165, 182, 423, 570, 733, 780
efekti erga omnes ablativ 182

efekti horizontal 133, 159, 685
efekti horizontal i kushtetutshmërisë 624
efekti i drejtpërdrejtë 133, 159
efekti i llojit të tretë 133, 159
efekti i përgjithshëm 468, 583, 584, 601, 604, 605 613, 615, 647
efekti i vendimit që ka fuqi të njëjtë me ligjin 714
efekti juridik 63, 446, 455, 462, 500, 570, 599, 614, 711, 738, 780
efekti rrezatues 133, 159, 689, 690
efektiv xi, 48, 157, 161, 255, 307, 335, 352, 376, 385, 401, 402, 405, 412, 428, 444, 450, 452, 453, 456, 527, 540, 571, 603, 606, 608, 612, 635, 658, 665, 675, 676, 677, 689, 704, 739, 755, 760, 792, 796, 834, 857, 860, 863, 873, 879, 949
efiçenca 574, 612
efori 36
Egjipti 76, 197, 198, 199, 200, 215
Eisenbergu 766, 786, 933
Ejup Statovci 328
ekspertët vendorë 348, 386
eksperti kushtetues 682
ekstra-juridike 619, 636, 637, 638, 662, 700,702, 706, 761, 799
ekstra-kushtetues 245, 373, 374, 519, 621, 636, 637, 638, 700
ekstra-ligjor 621
ekstra-njerëzore 434
Ekuadori 60, 62, 74, 78, 164, 172, 502
ekuilibri reflektiv 758
ekzistimi i shkaqeve 434
El Arad 237
El Salvador xvi, 164, 167, 174, 188, 945
elementi objektiv 499
elitike 192, 225, 386, 681
emërimi 493, 496, 512, 518, 526, 808
emetimi 664
Emiratet e Bashkuara Arabe 76, 195
emocionet 679
Empire of Arbitrary Jurisprudence 573
Emrush Kastrati 658, 659, 704, 941
enabling act 825
Engelbert Dollfuss 49
enigmatik 499
Enlarged Agreement 286
entrenched provisions 465, 474
Enver Hasani xiii, 111, 286, 305, 354, 362, 369, 384, 442, 454, 523, 543, 559, 594, 662, 800, 809, 810, 820, 829, 839, 894, 909, 910, 947, 949, 959
Epi i Gilgameshit 833
Epoka e Re 465, 467, 954
equity 577
Erdal Tercan 564
erga omnes 56, 59, 60, 64, 65, 68, 75, 88, 89, 93, 94, 97, 99, 100, 129, 130, 145, 162, 163, 164, 165, 173, 174, 176, 177, 178, 182, 184, 185, 187, 189, 211, 214, 251, 252, 257, 270, 282, 350, 351, 352, 355, 356, 390, 401, 423, 455, 489, 548, 553, 570, 577, 583, 584, 585, 613, 647, 660, 709, 710, 711, 713, 714, 716, 717, 718, 719, 720, 721, 722, 723, 729, 730, 731, 732, 733, 734, 736, 738, 740, 741, 752, 766, 772, 773, 775, 776, 778, 779, 780, 781, 847, 888
Estonia 50, 96, 103, 469, 518, 559, 901, 925
etika 261, 511, 537, 550, 564, 818
Euro-Azia 239
European Arrest Warrant Case 756
Evropa Jug-Lindore 134
Evropa Jugore 618, 652
Evropa komuniste 789
Evropa Lindore 239
evropian/kelsenian vii, 56, 57, 60, 61, 65, 72, 77, 87, 88, 89, 90, 92, 94, 100, 102, 104, 108, 113, 137, 138, 140, 151, 152, 153, 175, 191, 192, 214, 228, 238, 244, 245, 252, 255, 257, 276, 315, 331, 353, 361, 363, 364, 372, 377, 386, 390, 391, 395, 405, 421, 422, 425, 437, 449, 458, 476, 482, 514, 522, 565, 610, 646, 651, 655, 697, 712, 713, 715, 725, 729, 754, 778, 781, 813, 814, 864
ex ante 100, 395, 420, 443, 502, 503, 840, 843, 887
ex catedra 471
ex lege 546
ex nunc 146, 182, 477, 709, 716, 717, 728, 745, 746, 747, 783, 800

ex officio 37, 109, 113, 125, 167, 174, 180, 181, 182, 252, 421, 458, 498, 545, 547, 556, 603, 835, 957
ex post 42, 100, 395, 420, 443, 454, 502, 503, 504, 840, 843, 887
ex post facto 42
ex tunc 146, 169, 182, 709, 716, 717, 728, 739, 742, 744, 745, 746, 747, 782, 783, 800, 883
expresis verbis 397, 399
Express 465, 467, 949, 957

F

Fadil Hoxha 316
faktet kushtetuese 624, 753, 806, 813, 854, 855
fakti 78, 84, 94, 131, 133, 146, 148, 170, 194, 207, 219, 238, 239, 266, 272, 318, 324, 325, 331, 335, 336, 338, 351, 359, 360, 362, 373, 381, 382, 384, 403, 405, 408, 421, 439, 447, 453, 458, 464, 479, 480, 488, 514, 522, 557, 580, 589, 590, 593, 595, 603, 604, 608, 612, 627, 635, 642, 674, 688, 694, 695, 715, 716, 720, 744, 746, 747, 749, 751, 754, 755, 760, 774, 780, 795, 799, 806, 826, 830, 864, 865, 881, 882, 885
faktorët ambientalë ix, 625, 652
faktorët ambientalë apo rrethanorë 620
faktorët institucionalë 620
faktorët institucionalë 620, 621
faktorët ndërkombëtarë 493
fashizmi 691, 692, 742, 745, 783
Fatmir Fehmiu 328
Fatmir Sejdiu 379, 398, 446, 471, 482, 592, 631, 632, 633, 791, 794, 795, 796, 798, 800, 829, 882, 930, 943, 957
Federata e Çekosllovakisë 132
Federata e Malajzisë 254
Federata e Rusisë 145, 150, 159
Federica Mogherini 507
Feronikeli 869
fiksionet juridike 802
fiktive 106, 194, 215, 385, 427, 495, 508, 541, 556, 557, 560, 567, 810, 840, 844, 886
Finlanda 95, 286, 518, 532, 559
fleksibiliteti 452
Fletcher v Peck 85
formaliste 383, 684, 686, 696, 761, 785
format e tjera formale 499
Forumi i Venecias 289, 590, 596, 597, 598
Franc Kafka 558
Franca 39, 43, 44, 55, 56, 72, 75, 142, 193, 204, 207, 216, 273, 286, 309, 332, 349, 465, 485, 490, 518, 532, 559, 592, 682, 727, 729, 738, 745, 746, 781, 825, 882
Francisco Franco 74
Franko 47, 74, 691, 697, 698, 708
frankofone 219, 222, 273, 274, 275, 276, 277, 278, 279, 283, 284, 289
Fredrik Karl von Savinji 554
Freedom House 382, 699, 916, 956
Friedrich Carl von Savigny 554, 698, 723
Fruni v Sllovakia 411
fryma rusoane 56
fuhrer 91, 321
fuhrer serb 321
funksioni nomofilaktik 100, 270, 360, 720, 805
fuqia e detyrueshme e vendimeve 714
fuqia inspiruse 583

G / Gj

Gaboni 277, 502
Gadishulli Arabik 193, 194, 195
Gaius 577, 578, 895
Gamal Abdel Naser 197
Gambia 193
Gana 278
garancionet juridike 66
garancionet politike 66
garancionet shoqërore 66
gasi lotsjellës 836
Gazmend Zajmi 328
general measures 867
George Washington 275, 842, 903
Georg Jellinek 66
gerousia 36
Gjenerali Franko 691

Gjeorgia 129, 137, 292, 502, 512, 518, 559 865, 922
Gjermania e Hitlerit 229
Gjermania e Vajmarit 47, 58, 80, 594
Gjermania Naziste 220
gjuhët vernakulare 368
Gjykata Administrative 864, 866, 867
Gjykata e Auditimit 226
Gjykata e Kasacionit xvi, 56, 142, 226, 227
Gjykata e Strasburgut xv, 588, 591, 599, 603, 614, 654, 655, 673, 695, 713, 722, 757, 758, 785, 849, 853, 854, 855, 859, 861, 862, 864, 865, 866, 867, 871, 872, 873, 874, 875, 876, 877, 878, 879, 880, 881
gjykata hibride 493
gjykata kushtetuese kelseniane 419, 583
Gjykata Speciale 373, 409, 410, 412, 463, 465, 482, 629, 631, 663, 845
Gjykata Supreme e Egjiptit 76
Gjykata Supreme e Indisë 221, 470
Gjykata Supreme e Indonezisë xvii, 248
Gjykata Supreme e Kosovës xvi, 333, 361, 389, 394, 456, 477, 492, 543, 567, 732, 814, 941, 944
Gjykata Zorkin 146
gjykatat kushtetuese të vendeve evropiane 287, 597
Gjylijeta Mushkolaj 385
gjyqësia hibride 487, 488
gjyqësia kushtetuese 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 50, 53, 54, 55, 61, 65, 66, 68, 72, 73, 74, 75, 76, 79, 80, 83, 89, 90, 92, 106, 107, 108, 109, 122, 130, 138, 146, 158, 159, 163, 172, 191, 204, 210, 222, 227, 245, 249, 250, 265, 277, 279, 283, 284, 285, 301, 306, 327, 328, 370, 386, 387, 388, 394, 419, 422, 444, 472, 517, 528, 565, 572, 591, 623, 627, 631, 646, 648, 652, 678, 680, 684, 688, 723, 742, 756, 772, 773, 774, 813, 829, 839, 841, 851
gjyqësia kushtetuese gjermane 689, 727, 775, 781
gjyqësia kushtetuese irlandeze 763
Gjyqësor Yuan 266
gjyqësori aktiv 619, 700
gjysmë të plotë 401, 675, 706, 857, 865
Gorraiz Lizarraga et al. v. Spain 453
gouverner 71
greko-romake 33, 35, 37, 38
Greqia 35, 48, 56, 60, 72, 95, 96, 272, 286, 335, 388, 490, 596, 618, 652
Gresa Caka 508, 888
grosso modo 22, 164, 188, 232, 352, 360, 363, 402, 434, 563, 606, 609, 656
groundnorm 351
Grupi i Kontaktit 330, 332
Guatemala 59, 60, 63, 74, 164, 167, 171, 172, 176, 502, 919, 945
Guineja 275, 277
Gustavo Zagrebelsky 30, 54, 160, 404, 546, 737, 741, 743, 744, 895, 923

H

habeas corpus 171, 174, 176, 181, 189, 237
hadithet 28
Hadriani 577
Haga 329, 354, 373, 413, 480, 663, 845
Halit Muharremi 328
Hanah Arendt 220
Hanoveri 579
Hans Kelsen 25, 26, 30, 47, 48, 49, 53, 58, 67, 71, 80, 88, 92, 131, 242, 257, 351, 352, 364, 389, 391, 395, 399, 400, 419, 438, 459, 464, 473, 478, 490, 493, 494, 504, 515, 516, 517, 534, 565, 566, 623, 627, 628, 649, 664, 684, 689, 705, 737, 822, 832, 895, 897, 912
Hari Holker 338
Hashim Thaci 661
Heiligendamm 348
Helmut Steinberger 425, 438, 450, 460, 715, 723, 912, 954
heqja dorë 350, 454, 547
heshtja administrative 453
hibride 91, 278, 487, 488, 489, 493, 565, 834, 842
hibridizimi 81, 163, 598, 611
hijabi 200
Hirohito 49
Hirst v. the United Kingdom 591, 933

Holanda 100, 101, 103, 248, 503, 823, 885
Hondurasi 59, 164, 171, 172, 335
horizontal 22, 60, 84, 86, 133, 159, 225, 227, 273, 274, 362, 363, 368, 464, 598, 599, 600, 601, 605, 610, 624, 656, 657, 685, 707, 790, 863, 926
Hosni Mubarak 197
Human Rights Act 43, 100, 688, 696, 771
Human Rights Charter 693
hungarezët 309, 314, 319
Hungaria vii, 77, 125, 126, 313, 509, 518, 559, 562, 682, 729, 738, 745, 781, 841
Huriou 627

I

i centralizuar viii, 27, 60, 61, 63, 65, 89, 90, 162, 181, 219, 270, 276, 307, 309
i decentralizuar viii, 26, 27, 59, 60, 61, 65, 73, 80, 85, 86, 89, 92, 94, 98, 162, 164, 166, 167, 224, 270, 276, 277, 395, 491
i përgjithshëm x, 75, 94, 99, 172, 177, 180, 194, 294, 349, 357, 415, 417, 425, 426, 429, 445, 450, 453, 455, 493, 506, 530, 533, 541, 547, 574, 578, 584, 600, 601, 602, 608, 621, 649, 685, 691, 710, 711, 713, 715, 717, 726, 740, 743, 744, 746, 751, 766, 778, 790, 797, 803, 811
Ian Binnie 521
identiteti kushtetues 319, 331, 368, 369, 418, 628, 629, 637, 638, 640, 689, 827
identiteti kushtetues fillestar 631
identiteti kushtetues gjerman 833
identiteti kushtetues kosovar 372, 418, 637
ideologjitë nëpër shkolla 768
Iliria 834
Iliriana Islami 305, 385
Iluminizmi 54, 79
imagjinar 231, 427
imagjinuar 427, 572, 627, 724
Imam Mahdi 202
Imami i Fshehur 202, 204
Immanuel Kant 352
impeachmenti 542
imunitetet 406, 479, 496, 508, 518, 527, 532, 533, 544, 558, 566, 659, 700, 845
imuniteti (lirimi) nga përgjegjësia 532, 540
imuniteti absolut 540, 541, 542
imuniteti diplomatik 541, 543, 557, 559, 845
imuniteti funksional 532, 533, 534, 535, 536, 543, 559, 659
imuniteti i gjyqtarëve kushtetues 485, 486, 495, 508, 558, 559, 560
imuniteti i paprekshmërisë 532, 540, 541
imuniteti i përgjithshëm/absolut 532, 533, 534
imuniteti i përgjithshëm/absolut (non-violability) 532
imuniteti kushtetues funksional 557
imuniteti nga përgjegjësia 534
in abstracto 468, 469, 470, 476, 796, 816
in concreto 142, 469, 627, 734, 830
incompatibility declarations 746
Incorporated Council of Law Reporting 582
incostituzionalità accertata ma non dichiarata 751
Indet Perëndimore 185, 186, 189
Indet Perëndimore Britanike 185, 186, 189
India 50, 134, 221, 326, 367, 395, 465, 470, 628, 639, 894
India Britanike 326
individët 99, 140, 146, 148, 237, 241, 253, 261, 267, 273, 292, 316, 328, 333, 342, 357, 400, 429, 449, 450, 477, 522, 598, 599, 601, 710, 723, 724, 738, 746, 774, 775, 779, 810, 817
individual measures 867
Indonezia 78, 249, 250
infra 383, 409, 432, 439, 494, 497, 528, 536, 539, 543, 544, 548, 630, 725, 815
institucioni i abstenimit 537
institucioni i Avokatit të Popullit 289, 297
institucioni i kontrollit 66
institucioni i ombudspersonit 373
instituti i ankesës kushtetuese 171, 306, 326
instituti i kooptimit 485
institutiones 578
integralizmi jugosllav 309, 310, 312
inter 22, 43, 56, 60, 75, 79, 86, 88, 89, 97, 100, 127, 135, 143, 148, 162, 163, 164, 165,

168, 169, 171, 173, 174, 175, 180, 181, 182, 187, 252, 269, 281, 288, 338, 358, 367, 369, 380, 381, 390, 395, 396, 412, 417, 455, 457, 466, 498, 505, 522, 548, 575, 611, 636, 646, 660, 673, 704, 709, 711, 714, 715, 717, 723, 731, 733, 738, 740, 753, 766, 778, 779, 780, 782, 793, 799, 823, 858, 867, 868, 872, 880, 882

inter alia 22, 43, 79, 86, 127, 135, 143, 148, 162, 173, 252, 269, 281, 288, 338, 358, 367, 369, 380, 381, 412, 417, 466, 498, 505, 522, 548, 636, 646, 673, 714, 738, 753, 766, 782, 793, 799, 823, 858, 867, 872, 882

inter partes 56, 60, 75, 88, 89, 97, 100, 163, 164, 165, 168, 169, 171, 173, 174, 175, 180, 181, 182, 187, 252, 390, 395, 396, 455, 457, 575, 611, 660, 704, 709, 711, 714, 715, 717, 723, 731, 733, 740, 778, 779, 780, 868, 880

interesi direkt/i drejtpërdrejtë 422, 453, 455, 456

interesi direkt juridik 422

interlokutore 874, 876

interpretimi 24, 30, 39, 40, 41, 46, 47, 63, 71, 85, 127, 139, 150, 153, 155, 157, 161, 162, 175, 198, 199, 203, 215, 241, 242, 262, 263, 264, 265, 266, 267, 271, 278, 310, 315, 336, 343, 351, 369, 374, 386, 389, 390, 391, 392, 393, 396, 397, 398, 399, 400, 415, 416, 417, 423, 437, 443, 447, 460, 462, 477, 505, 534, 574, 577, 579, 581, 594, 597, 599, 611, 636, 643, 647, 660, 661, 662, 669, 680, 681, 693, 694, 698, 703, 712, 720, 721, 724, 731, 733, 734, 741, 755, 758, 762, 792, 807, 808, 816, 817, 829, 841, 842, 843, 861, 937, 942, 943

interpretimi i pastër kushtetues auto-referencial 398, 399

interpretimi konform-kushtetutës 664, 669, 670, 704, 705

interpretimi kushtetues 157, 262, 264, 351, 389, 396, 397, 399, 423, 712, 731, 842

interpretimi kushtetues 24, 26, 84, 254, 267, 283, 389, 390, 479, 575, 641, 693, 712, 756, 765

interpretimi positivist 278

interpretimi tekstual 278, 640, 690

interpretimi zyrtar 155, 157

interregnum 806

intervenimi kirurgjik 670

inviolability 532, 540

ipso facto 795, 820

Iraku 76

Irani viii, 194, 195, 196, 197, 200, 201, 203, 215, 465

Irlanda 96, 100, 286, 518, 532, 727, 745, 764, 785

Irlanda e Veriut 696

Isa Mustafa 466, 777, 800, 810, 947

ish-BRSS 39, 106, 143, 144, 145, 150, 151, 154, 309, 314, 321, 324, 326, 375, 612

ish-Jugosllavia 49, 111, 113, 148, 151, 158, 301, 318, 322, 326, 386, 406, 540, 565, 820

ish-koloni britanike 186, 396, 764

ish-komuniste xvi, 23, 25, 28, 30, 39, 49, 50, 54, 72, 73, 77, 78, 105, 106, 108, 122, 130, 131, 140, 151, 155, 159, 256, 275, 285, 288, 296, 302, 305, 306, 315, 335, 362, 363, 365, 366, 368, 370, 382, 383, 386, 387, 388, 403, 442, 461, 472, 477, 478, 486, 509, 512, 513, 514, 515, 516, 530, 532, 539, 540, 542, 560, 569, 580, 581, 584, 587, 590, 595, 612, 617, 620, 621, 625, 627, 640, 643, 652, 653, 675, 678, 681, 682, 685, 697, 699, 703, 726, 741, 745, 747, 748, 790, 798, 825, 826, 828, 840, 841, 850, 853, 868, 875, 880

ish-Kryetari i Gjykatës 531, 532, 543, 556, 557

ish-republikë sovjetike 134, 138, 239

ish-vende komuniste 78, 238, 287, 403, 448, 516, 542, 567, 584, 620, 819

Islami 191, 192, 193, 194, 196, 197, 198, 199, 201, 202, 203, 205, 208, 210, 217, 221, 249, 253, 254, 255, 281, 492, 639, 891, 898, 918, 927, 928, 940

Islami Shia 196, 201, 202

Islami Suni 202, 221

Islanda 518, 559, 562, 590

Ismail Kadare 151

Ismet Salihu 328

Israel Poultry Farmers Association v. Government of Israel. 236, 954

Italia 25, 29, 48, 122, 204, 272, 286, 311, 332, 349, 388, 397, 465, 479, 490, 503, 509, 514, 515, 518, 542, 559, 562, 642, 682, 692,

707, 727, 738, 745, 784, 825, 830, 905, 918
iudex a quo 166, 167, 168, 169, 182, 188
iudex inhabilis 545, 546, 547, 548, 551, 567
iudex supsectus 549
iure gestionis 869
iure imperi 869
ius civile 575, 577
ius honorarium 575
Iusitinian 578
Ivan Cukallovic 511, 527, 594, 662, 894
Izraeli viii, 194, 229, 230, 231, 235, 238, 285, 469, 745, 764

J

jaka e bardhë 542
Jakup Krasniqi 398, 468, 631, 633, 800, 829, 930, 944
Janos Nemeth 690
Japonia viii, 22, 25, 29, 72, 258, 264, 268, 269, 270, 283, 503, 518, 532, 559
jashtë përgjegjësive të tyre 536
Jean-Jacques Rousseau 40, 363
Jellinek 66
Jemeni 76, 209
Jersulemi 229
Jerusalemi i Jordanisë 230
Jerusalemi Lindor 229, 230
Jerusalemi Perëndimor 230
Jezu Krishti 366
Johan Van Lemon 496
John 25, 38, 45, 51, 53, 57, 81, 83, 84, 85, 97, 104, 207, 210, 232, 268, 366, 367, 403, 415, 554, 574, 617, 622, 686, 692, 718, 736, 744, 745, 797, 842, 853, 873, 896, 897, 899, 904, 914, 920, 921, 922, 923, 927
John Jay 842
John Tunheim 367, 921
Johnatan Swift 571
jokushtetutshmëri e verifikuar por jo e shpallur 751
jomeritore 415, 724, 837, 852
Jordania 76, 209
jotranformative 335
jucio de amparo 62
Judea dhe Samaria 230
Judean 230
judgement 226, 452, 453, 591, 606, 608, 763, 827, 908, 931, 933, 934, 945
Judicature Act 582, 926
judicial review 89, 100, 161, 389, 712, 843, 886
Judicial Settlement Act 564
Jugosllavia vii, 49, 51, 72, 73, 105, 106, 111, 112, 113, 129, 158, 301, 302, 306, 307, 309, 311, 314, 324, 325, 374, 375, 820
Jugosllavia e tretë 302
Jugosllavia e Versajës 309
Jugosllavia Federative Demokratike 313
jugosllavizmi integral 309, 310, 312
juridiksioni ix, 26, 66, 95, 98, 132, 136, 139, 155, 183, 184, 197, 198, 250, 254, 257, 316, 328, 333, 347, 354, 367, 375, 380, 389, 390, 400, 405, 409, 410, 411, 413, 414, 420, 421, 426, 439, 440, 443, 445, 446, 448, 449, 455, 456, 457, 459, 461, 476, 491, 600, 601, 609, 614, 631, 632, 634, 644, 645, 661, 662, 675, 692, 706, 711, 795, 807, 814, 829, 830, 832, 838, 842, 844, 847, 849, 887
juridiksioni këshillëdhënës 479, 662, 840
juridiksioni plotësues 443
juridiksioni shtesë 137, 180, 183, 229, 420, 421, 476, 477, 479, 483, 821, 839, 840, 884
jurisprudenca constante 580, 583
jurisprudenca e koncepcioneve 578
jurisprudenca gjermane 370, 450, 457, 464, 473
jurist 147, 227, 347, 382, 487, 490, 493, 494, 496, 504, 509, 514, 515, 517, 558, 578, 594, 622, 845
jus cogens 350, 355, 559, 588, 598, 699
jus naturale 38, 39
jus positivum 38, 39, 44
Justiniani 578

K

Kaçaniku 327, 376
Kadri Kryeziu 305, 385, 508, 520, 522, 523, 527, 536, 557, 941
Kai Aide 334, 345, 346

Kajroja 200
Kalifornia 563
kamata ndëshkuese 464, 812
kamatëvonesa 464, 818
Kamboxha 134
Kameruni 277, 502
Kanadaja 45, 48, 50, 60, 396, 518, 521, 532, 559, 682, 693, 707, 735
Kanali i Korfuzit 392
kantonet zvicerane 293
Karagjorgjeviq 302, 307, 308, 309, 310, 311, 312, 313
Karaibet xv, 187, 194
karakter deklarativ 545, 711, 868, 875, 880
Karel Visak 585
Karl Shmit 26, 30, 36, 48, 53, 67, 69, 73, 80, 91, 131, 351, 352, 364, 428, 459, 464, 474, 628, 652, 689, 804
Karner v. Austria, 453
karta 33, 39, 51, 83, 119, 315, 361, 460, 469, 683
Karta e OKB 311, 339, 340
Karta e të Drejtave të Gjyqësorit 236
Karta e të Drejtave të Njeriut në Izrael 236
karta e vetëqeverisjes 315
Karta Evropiane për Vetëqeverisje 592
Karta Gjermane e të Drejtave të Njeriut 790
karta koloniale 51
Karta Kushtetuese 119, 304, 323
Karta Kushtetuese 120, 322
Karta mbi të Drejtat Themelore e BE 401
Karta për të Drejtat e Njeriut 693
kasacioni kushtetues 170, 178
Katalonia 769
Katari 193, 195
Kaukazi Jugor 239
Kazakistani 241, 280
kelsenian vii, 27, 44, 54, 56, 57, 60, 61, 65, 72, 73, 77, 78, 79, 81, 87, 88, 89, 90, 92, 94, 100, 102, 104, 106, 107, 108, 113, 120, 129, 137, 138, 140, 151, 152, 153, 158, 172, 175, 191, 192, 214, 228, 238, 244, 245, 252, 255, 257, 276, 315, 331, 347, 351, 352, 353, 361, 363, 364, 372, 377, 386, 390, 391, 395, 400, 404, 405, 415, 421, 422, 423, 425, 437, 438, 449, 458, 476, 482, 485, 487, 489, 490, 491, 493, 496, 503, 504, 514, 515, 516, 522, 523, 528, 531, 565, 583, 610, 613, 617, 620, 627, 646, 651, 652, 655, 670, 697, 710, 712, 713, 715, 725, 728, 729, 733, 735, 753, 754, 755, 772, 778, 781, 813, 814, 855, 864
këmbët e karriges 724, 753, 754, 756, 757, 758, 760, 762, 763, 764, 765, 766, 767, 768, 769, 770, 771, 772, 773, 784, 786, 799, 801, 833, 854, 855, 883
kërkesa e plotë kushtetuese 450
kërkesa kushtetuese 609, 660
kërkesa origjinale 662, 835, 844, 855, 856, 857, 859, 887
kërkesa për konflikt për kompetencë kushtetuese 844, 887
Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë 658
kërkesa për moszbatim 75
kërkesa për përsëritje të procedurës 855, 856, 868, 874
kështillat gjyqësore 290, 365
Këshilli Federal 173, 562
Këshilli Gjyqësor 134, 514, 543
Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial 226, 227
Këshilli Gjyqësor i Kosovës 496, 505, 539
Këshilli Gjyqësor të Kosovës 543
Këshilli i Bashkimit Evropian 494, 505
Këshilli i Evropës 239, 379, 384, 611, 841, 959
Këshilli i Gardianëve 203, 204
Këshilli i Lartë i Edukimit 227
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës 491, 492, 939, 940
Këshilli i Përbashkët 290
Këshilli i Përbashkët xviii, 289, 290
Këshilli i Revizionit 86
Këshilli i Shtetit 61, 62, 100, 101, 226, 227, 273
Këshilli i Shurasë 194, 195, 196, 215
Këshilli i Sigurimit 230, 306, 342, 349, 350, 360, 473, 558, 820
Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara 494
Këshilli i të Vjetërve 36

Këshilli Kushtetues 39, 142, 216, 242, 490, 522, 594, 670, 729, 738, 744
Këshilli Kushtetues xviii, 41, 206, 208, 210, 216, 242, 730, 738, 744, 761
Këshilli Kushtetues i Francës 216, 490, 522
Këshilli Mbretëror i Drejtësisë 693
Këshilli për Zgjedhjet 293, 294, 297
Këshilli për Zgjedhjet Demokratike 293, 297
Këshilli për Zgjedhjet Demokratike 294
Këshilli Suprem 210
Kina 39, 259, 261, 262, 263, 264, 265, 282, 516
Kirgistani 244
Kirgistani viii, 238, 242, 280, 285, 293, 465
kirurgjia gjyqësore 669, 705
Kisha Katolike 408, 554, 697, 727
Kisha Ortodokse Serbe 408
KLAN KOSOVA 809, 949
klauzola e kufizimit 233, 235
klauzola e përjetësisë 465
klauzola e rrënjosjes 233
Knesset 231, 232, 233, 234, 235, 236, 764, 765, 785, 908, 931
Kodi Civil 133, 698, 708
Kodi Civil i Gjermanisë 690
Kodi Civil i Tajvanit 769
Kodi Civil Spanjoll 698, 708
kodi gjenetik 472
Kodi i Etikës 384, 524, 550
Kodi i Etikës i Gjykatës Kushtetuese 384
Kodi i Justinianit 549
Kodi i Procedurës Civile 166, 175
Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale 548, 880
Kodi për Referendumet 293, 294
Kodi për Zgjedhjet 293, 294
Kodi Zgjedhur 439
kodifikimi 33, 41, 574, 577, 578, 579, 686
Koha ditore 384, 385, 471, 949, 955
koha fashiste 742, 783
Kolegji i Ankesave 803, 833
Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës 833
Kolegji i Apelit 457, 596, 665, 834, 942
Kolegji Shqyrtues i Gjykatës Kushtetuese 556
Kolumbia 47, 59, 60, 74, 75, 78, 164, 172, 181, 189, 502
Komatsu v Japan 269
Kombet e Bashkuara xv, xviii, xix, 229, 230, 303, 306, 311, 342, 350, 494, 558, 665, 802, 803, 820, 938
kombi jugosllav 310
Komentari i Kushtetutës së Kosovës 597
Komisioni i Venecias xviii, 127, 128, 150, 157, 159, 160, 192, 211, 212, 213, 285, 296, 330, 377, 421, 422, 435, 478, 529, 533, 542, 562, 567, 596, 853
Komisioni për Kodifikim 258
Komisioni për Reformën e Zgjedhjeve Presidenciale 800
Komisioni për të Drejtat e Njeriut 605
Komiteti xviii, 134, 143, 144, 145, 149, 173, 247, 261, 262, 263, 285, 286, 288, 307, 347, 592, 847, 866, 867, 875, 876, 879, 880
Komiteti i Ministrave xviii, 149, 347, 592, 847, 866, 867, 875, 876, 879, 880
Komiteti Jugosllav 307
komiteti kushtetues 251
Komiteti për Mbikëqyrjen Kushtetuese 247
Komiteti Permanent i Kongresit Popullor 262
Komoro 277
kompetenca 21, 22, 30, 46, 47, 51, 57, 58, 59, 60, 66, 67, 69, 74, 78, 87, 92, 94, 96, 98, 99, 108, 114, 116, 118, 119, 120, 122, 123, 124, 125, 130, 132, 133, 136, 138, 140, 141, 142, 144, 145, 148, 149, 152, 154, 155, 158, 159, 162, 167, 168, 174, 175, 176, 178, 180, 182, 184, 203, 204, 207, 211, 212, 213, 214, 219, 228, 236, 241, 242, 245, 246, 247, 248, 249, 251, 252, 257, 265, 272, 274, 277, 281, 301, 316, 318, 323, 328, 332, 343, 344, 349, 357, 358, 375, 376, 379, 381, 388, 390, 393, 396, 397, 416, 419, 420, 423, 426, 427, 438, 447, 468, 481, 490, 491, 503, 505, 540, 558, 560, 562, 597, 600, 610, 623, 625, 632, 645, 647, 650, 656, 662, 663, 672, 688, 689, 691, 692, 694, 698, 711, 714, 718, 730, 768, 792, 807, 808, 812, 839, 841, 843, 844, 845, 887

Komuna e Deçanit 833, 834, 835, 886
Komuna e Prizrenit 443, 452, 637, 676, 677, 939
Komuna e Rahovecit 632
koncentruar viii, 74, 87, 88, 93, 143, 162, 164, 165, 168, 172, 173, 174, 175, 177, 178, 181, 183, 184, 185, 188, 189, 219, 242, 243, 257, 259, 265, 268, 271, 276, 277, 395, 624
Konferenca Botërore 290, 521
Konferenca e Krimesë 313
Konferenca e Rambujesë 330, 332
Konferenca Elektorale 293
Konferenca Evropiane 290
konflikti absolut i interesit 552
konflikti i interesit 209, 507, 511, 519, 521, 547, 549, 551, 567, 843
konflikti negativ 843
konflikti për kompetencë 138, 396, 656, 663, 792, 843, 844, 887
konflikti për kompetencë 214, 427, 610, 843, 844
konflikti për kompetencë në çështjet kushtetuese 844
konflikti pozitiv për kompetencë 843
konfuçianizimi i ligjit 259
konfucianizmi 259
Kongoja 78, 277
Kongresi xviii, 84, 86, 144, 145, 161, 162, 166, 173, 261, 262, 263, 288, 293, 297, 540
Kongresi Amerikan 86, 540
Kongresi i Deputetëve të Popullit 144
Kongresi i Meksikos 178
Kongresi Popullor i Republikës Popullore të Kinës 261, 262, 263
konkret ix, 29, 42, 63, 66, 69, 70, 73, 87, 88, 91, 92, 93, 94, 96, 100, 103, 138, 148, 163, 164, 165, 167, 168, 169, 172, 175, 178, 179, 180, 206, 210, 227, 253, 258, 267, 268, 277, 287, 351, 352, 353, 356, 357, 359, 360, 370, 379, 380, 381, 383, 391, 392, 393, 401, 414, 415, 418, 419, 425, 432, 440, 449, 450, 451, 452, 454, 455, 456, 457, 458, 460, 462, 466, 475, 499, 501, 502, 506, 514, 518, 519, 521, 527, 536, 543, 545, 546, 547, 548, 549, 550, 551, 558, 559, 565, 575, 577, 594, 595, 597, 599, 600, 602, 603, 606, 614, 617, 619, 620, 624, 625, 629, 635, 643, 659, 672, 677, 678, 679, 687, 689, 691, 692, 711, 714, 717, 718, 720, 728, 730, 758, 759, 765, 768, 778, 779, 786, 787, 796, 800, 806, 808, 815, 816, 830, 838, 843, 849, 852, 853, 861, 863, 867, 869, 872, 881
konkurrues 603, 615, 726
konsensusi i Uashingtonit 366
konsociacional 427, 428, 481, 850
konsociacional i demokracisë 427, 428, 481
konstitucionalizimi 408, 463, 467, 818
konstitucionalizimi i fajdes 818
konstitucionalizmi 23, 29, 104, 106, 132, 161, 187, 191, 192, 193, 204, 214, 220, 274, 366, 432, 471, 481, 692, 760
konstitucionalizmi afrikan 274
konstitucionalizmi funksional 760
konstitucionalizmi strukturor 274
konstituive 350, 711, 714
konstitutcionalizmi gjyqësor 274
konsultativ apo këshilldhënës 840
kontinental 39, 59, 61, 90, 161, 162, 163, 165, 169, 170, 171, 187, 276, 383, 386, 548, 563, 564, 569, 651, 706, 727, 735, 852, 873
kontrolli abstrakt 44, 152, 165, 184, 188, 235, 244, 250, 257, 269, 280, 388, 391, 405, 422, 475, 491, 493, 610, 625, 628, 672, 709, 731, 843
kontrolli abstrakt 92, 93, 122, 144, 155, 227, 258, 281, 388, 390, 394, 401, 415, 419, 422, 439, 458, 462, 468, 469, 475, 478, 479, 482, 490, 613, 625, 628, 638, 640, 648, 669, 686, 692, 694, 701, 703, 705, 710, 711, 713, 714, 723, 727, 728, 730, 731, 732, 734, 749, 778, 818, 841
kontrolli abstrakt a posteriori 93
kontrolli abstrakt i normës 475, 610, 625, 628, 672, 709, 843
kontrolli abstrakt i normës juridike 625, 709
kontrolli difuz 63, 270
kontrolli gjyqësor 26, 45, 58, 66, 79, 80, 84, 96, 97, 103, 147, 161, 163, 186, 187, 197, 235, 237, 238, 274, 280, 390, 393, 626, 694
kontrolli gjyqësor 34, 62, 73, 84, 97, 98, 175, 186, 198, 201, 234, 276, 314, 375, 389, 476, 514, 626, 694

kontrolli gjyqësor vii, 33, 44, 62, 65, 68, 76, 81, 84, 86, 89, 95, 96, 97, 100, 107, 151, 161, 164, 166, 187, 197, 231, 238, 390, 618, 694, 712

kontrolli gjyqësor i kushtetutshmërisë 33, 39, 40, 45, 47, 48, 56, 61, 62, 65, 72, 73, 75, 76, 80, 85, 97, 102, 103, 187, 232, 314, 363, 389, 423, 617, 626, 650, 723, 765, 842

kontrolli gjyqësor i kushtetutshmërisë 33, 62, 65, 81, 86, 95, 97, 100, 164, 166, 187, 201, 231,234, 314, 375, 389,694 712

kontrolli i decentralizuar 92, 224

kontrolli i drejtpërdrejtë 235, 280

kontrolli i konvencionalitetit 97, 103, 426, 437, 442, 482, 506

kontrolli i kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese 374, 463, 628, 636, 648

kontrolli i ligjshmërisë 96, 98, 266, 364, 386, 491, 492

kontrolli i tërthortë 235, 280

kontrolli i tërthortë 95, 236, 280

kontrolli i verifikimit normativ 155

kontrolli incidental 58, 180, 254, 317, 333, 457, 460, 642, 734, 778

kontrolli incidental ix, 78, 142, 155, 172, 219, 246, 248, 252, 257, 394, 395, 396, 450, 456, 458, 459, 460, 483, 597, 642, 668, 669, 687, 692, 729, 731, 732, 733, 734, 740, 744, 781, 813, 814

kontrolli incidental i kushtetutshmërisë 184, 227, 252, 254, 388

kontrolli incidental i kushtetutshmërisë 277, 317

kontrolli incidental pan-evropian 479

kontrolli kushtetues 22, 25, 27, 29, 36, 42, 44, 47, 57, 60, 75, 85, 86, 94, 99, 100, 106, 111, 128, 141, 155, 156, 161, 165, 184, 186, 193, 197, 213, 215, 216, 219, 224, 235, 237, 242, 245, 247, 251, 269, 282, 363, 389, 396, 399, 418, 422, 424, 428, 442, 448, 450, 462, 466, 470, 475, 477, 490, 504, 629, 630, 664, 669, 701, 722, 730, 759, 808, 811, 830, 832, 873, 884

kontrolli kushtetues vii, 22, 24, 26, 29, 40, 45, 49, 50, 59, 60, 61, 73, 77, 80, 87, 88, 89, 92, 93, 94, 97, 103, 107, 128, 143, 144, 145, 151, 152, 153, 164, 175, 182, 186, 188, 189, 195, 197, 198, 209, 211, 237, 241, 242, 252, 276, 280, 308, 311, 353, 363, 391, 396, 399, 402, 415, 427, 438, 439, 441, 442, 445, 449, 454, 461, 473, 475, 481, 503, 504, 506, 547, 553, 554, 595, 600, 610, 624, 627, 628, 629, 636, 641, 672, 674, 692, 702, 711, 712, 723, 734, 746, 776, 778, 804, 822, 824, 827, 829, 831, 833, 841, 856, 857, 859, 868, 869, 884, 886

kontrolli kushtetues abstrakt a posteriori 92, 93, 103

kontrolli kushtetues i amendamenteve kushtetuese 88, 372, 629, 641, 778

kontrolli kushtetues i ligjvënies së zakonshme 628

kontrolli kushtetues i marrëveshjeve ndërkombëtare 152, 438, 442, 504, 827

kontrolli kushtetues i verifikimit normativ 156

kontrolli kushtetues incidental 26

kontrolli kushtetues konkret a posteriori 92, 94, 103

kontrolli kushtetues ndaj veprimeve të shteteve anëtare 85

kontrolli kushtetues normativ kolateral 156

kontrolli kushtetues preventiv 92, 103, 280

kontrolli kushtetues represiv 155

kontrolli politik 33, 59, 63, 73, 79, 91, 161, 186, 215, 224, 256, 263

kontrolli politik i kushtetutshmërisë 61, 62, 79, 161, 224, 262

kontrolli politiko-ushtarak i kushtetutshmërisë 91

kontrolli preventiv 42, 43, 93, 100, 242, 465, 490, 666, 734, 800, 827, 885

kontrolli prioritar i kushtetutshmërisë 142

kontrolli represiv 42, 44, 51, 156, 277, 503, 666, 734, 831, 832

kontrolli represiv dhe abstrakt i normës 156

kontrolli represiv i kushtetutshmërisë së ligjeve 42, 207

kontrolli represiv i kushtetutshmërisë së traktateve ndërkombëtare 257

Konventa 604, 611, 642, 758, 846, 847, 851, 852, 861, 862, 868, 869, 874, 875, 876, 877, 878, 880, 881

kooptimi 516
Kosova sot 384, 385, 386, 468, 637, 955, 956
Krasniqi v. RTK 453, 455, 456
kritikat dhe analizat profesionale 383
Kroacia 115, 116, 293, 302, 518, 559, 562, 596, 629, 639, 827
Kryeministri i Kosovës 534
Kryeprokurori i Shtetit 676, 706, 881
Kryetari i Gjykatës Kushtetuese 531
Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës 535
Kryetari i Kosovës 492
Kryetari i LDK 447
KSA të Kosovës 304, 317, 318, 326, 934
KTV 466
Kuba 48, 57, 64, 72, 80, 106, 185
kufijtë e ligjvënies së tij negative 666
kufizimet e lirive dhe të drejtave të njeriut 429
kufizimi 40, 79, 193, 233, 235, 429, 430, 464, 673, 771
kujtesa historike 679
kultura e përgjithshme juridike në nivel lokal 681
kultura juridike 239, 549, 622, 681, 682, 686, 687, 691, 693, 696, 697, 698, 708
kultura kushtetuese 678, 679, 681, 686, 692, 694, 727
kultura kushtetuese italiane 692, 707
kultura kushtetuese komuniste 680
kultura politike 679, 681
kundërshtimi 24, 37, 48, 67, 85, 91, 98, 108, 124, 128, 149, 150, 179, 180, 182, 201, 221, 231, 233, 234, 236, 243, 244, 262, 266, 267, 283, 308, 309, 317, 322, 323, 350, 359, 360, 372, 376, 400, 433, 447, 455, 469, 480, 493, 504, 521, 543, 544, 587, 592, 604, 607, 646, 647, 660, 664, 695, 738, 741, 742, 752, 763, 777, 782, 797, 804, 805, 810, 814, 830, 833, 836, 886
Kuomintang 259, 265, 266
kuorumi 385, 445, 536, 545, 556, 948, 955
kuptimi derivativ 618
kuptimi i lirisë si një e drejtë reziduale 762, 785
Kurani i Shenjtë 196, 197, 221
Kushtetuta viii, xvii, xviii, 24, 25, 29, 36, 43, 46, 47, 48, 49, 56, 57, 61, 63, 64, 65, 68, 70, 73, 74, 75, 76, 83, 84, 85, 91, 93, 96, 98, 101, 102, 103, 108, 113, 114, 115, 120, 121, 122, 123, 126, 127, 128, 129, 130, 133, 134, 135, 136, 137, 138, 139, 144, 145, 147, 148, 150, 151, 152, 153, 156, 157, 159, 160, 162, 166, 167, 168, 170, 174, 175, 176, 178, 179, 180, 182, 187, 188, 201, 202, 203, 204, 208, 210, 212, 213, 215, 222, 223, 224, 225, 231, 232, 240, 242, 243, 245, 247, 251, 253, 254, 258, 259, 261, 262, 263, 266, 268, 269, 270, 271, 272, 273, 279, 283, 303, 304, 305, 306, 308, 310, 311, 312, 314, 315, 317, 318, 319, 321, 322, 323, 327, 329, 330, 331, 332, 333, 334, 335, 336, 349, 351, 352, 357, 358, 361, 362, 366, 367, 369, 373, 375, 376, 379, 383, 389, 392, 397, 398, 404, 405, 407, 415, 416, 417, 427, 428, 430, 431, 432, 434, 435, 436, 439, 441, 443, 445, 449, 455, 460, 462, 465, 474, 478, 481, 486, 494, 496, 498, 508, 514, 517, 518, 519, 528, 529, 532, 533, 539, 542, 544, 546, 553, 561, 584, 585, 588, 598, 601, 602, 609, 618, 619, 622, 623, 626, 634, 637, 662, 673, 683, 684, 687, 690, 692, 693, 694, 697, 698, 720, 729, 730, 731, 769, 774, 777, 798, 811, 814, 815, 816, 823, 829, 830, 839, 842, 844, 850, 852, 885, 886, 894, 921, 934, 947
Kushtetuta e Afrikës së Jugut 271
Kushtetuta e Argjentinës 166
Kushtetuta e Argjentinës 170
Kushtetuta e Argjentinës 170
Kushtetuta e Armenisë 134
Kushtetuta e Austrisë xvii, 47, 49, 774, 777, 934
Kushtetuta e Barbados 187
Kushtetuta e Belgjikës 404
Kushtetuta e Çekisë 133
Kushtetuta e Egjiptit 197, 215
Kushtetuta e Ekuadorit 64, 75
Kushtetuta e El Salvadorit 167
Kushtetuta e El Savadorit 174, 188
Kushtetuta e Estonisë 99
Kushtetuta e Federatës së Rusisë 147
Kushtetuta e Federatës së Rusisë 149
Kushtetuta e Francës 42, 61, 93, 688, 730,

738
Kushtetuta e Francës 729
Kushtetuta e Gjeorgjisë 137
Kushtetuta e Holandës 101
Kushtetuta e Hondurasit 167
Kushtetuta e Hungarisë 126, 127, 730, 763
Kushtetuta e Indisë 395
Kushtetuta e Indonezisë 249
Kushtetuta e Irlandës 100
Kushtetuta e Irlandës 763
Kushtetuta e ish-Bashkimit Sovjetik 129
Kushtetuta e ish-BRSS-së të vitit 1977 144
Kushtetuta e Japonisë 268
Kushtetuta e Japonisë 268, 270
Kushtetuta e Japonisë 49, 270
Kushtetuta e Jugosllavisë 310, 375
Kushtetuta e Jukatanit të vitit 1840 63
Kushtetuta e Kanadasë 693
Kushtetuta e Kazakstanit 241
Kushtetuta e Kilit 162
Kushtetuta e Kinës 259
Kushtetuta e Kinës 263
Kushtetuta e Kolumbisë 63, 64, 65
Kushtetuta e Kolumbisë së Madhe 63
Kushtetuta e Koresë së Jugut 251
Kushtetuta e Kosovës 103, 332, 333, 334, 349, 362, 829
Kushtetuta e KSA të Kosovës 304, 312, 934
Kushtetuta e KSAK 312, 328
Kushtetuta e Malajzisë 281
Kushtetuta e Malejzisë 255
Kushtetuta e Maqedonisë së Veriut 121
Kushtetuta e Marokut 207, 208
Kushtetuta e Meksikos 62
Kushtetuta e Moldavisë 138, 396
Kushtetuta e Mongolisë 255
Kushtetuta e Norvegjisë 474
Kushtetuta e Norvegjisë 97, 475
Kushtetuta e Pakistanit 221
Kushtetuta e Paksitanit 221
Kushtetuta e Panamasë 65
Kushtetuta e Perandorisë Otomane 223
Kushtetuta e Përhershme e Kinës 259
Kushtetuta e Perusë 62, 75
Kushtetuta e Polonisë 129
Kushtetuta e Polonisë 129, 130, 159, 730
Kushtetuta e Portugalisë 73
Kushtetuta e Rajhut Gjerman 623
Kushtetuta e Rambujesë 333, 335, 336, 376
Kushtetuta e Republikës Islamike të Pakistanit 201
Kushtetuta e Republikës Popullore të Kinës 262
Kushtetuta e Republikës së Azerbajxhanit 239, 240
Kushtetuta e Republikës së Karakalpakstan 247
Kushtetuta e Republikës së Kirgistanit 243
Kushtetuta e Republikës së Kosovës 369, 379, 398, 417, 441, 463, 496, 505, 543, 544, 592, 594, 596, 597, 632, 635, 636, 638, 660, 661, 712, 724, 742, 791, 792, 801, 807, 814, 822, 829, 885, 930, 934, 937, 942, 943, 944
Kushtetuta e Republikës së Kroacisë 115
Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë 152
Kushtetuta e Republikës së Taxhikistanit 245
Kushtetuta e Republikës së Turqisë 222, 223
Kushtetuta e RFJ 304
Kushtetuta e RFPJ 303
Kushtetuta e RSFJ 113, 303, 304, 314, 317, 318, 319
Kushtetuta e Rumanisë 140, 397
Kushtetuta e Serbisë 124, 125, 321, 327, 348, 827
Kushtetuta e SHBA 83, 85, 232, 415, 474, 542, 618, 626
Kushtetuta e Shqipërisë 151, 160
Kushtetuta e Singaporit 253, 255, 281
Kushtetuta e Tajvanit 266
Kushtetuta e Tunizisë 210, 213
Kushtetuta e Tunizisë 211
Kushtetuta e Urugvajt 65
Kushtetuta e Vajmarit 48, 131, 404
Kushtetuta e Vajmarit 48, 55, 71, 80, 465, 474, 584
Kushtetuta e Vajmarit xviii, 404, 623

kushtetuta e vdekur 640
Kushtetuta e Venezuelës 167
Kushtetuta e Venezuelës 63
Kushtetuta e Vidovdanit 303, 308
Kushtetuta e Vidovdanit 309
Kushtetuta e vitit 1831 61
Kushtetuta e vitit 1851 62, 162
Kushtetuta e vitit 1911 94
Kushtetuta e vitit 1917 62, 171
Kushtetuta e vitit 2008 124, 330, 335, 336, 338, 341, 351, 352, 354, 355, 357, 361, 365, 367, 377, 387, 407, 411, 413, 419, 421, 428, 467, 476, 478, 483, 486, 487, 489, 493, 494, 495, 529, 597
Kushtetuta e Vogël 129, 310
Kushtetuta e Xhamaikës 187
Kushtetuta e Zhablakut 322, 330
Kushtetuta e Zhabljakut 323
Kushtetuta Federale 107, 108, 109, 171
Kushtetuta MacArtur 268
Kushtetuta Meiji 268
kushtetutat e ndërkombëtarizuara 851
kushtetutat e ngurta 471
kushtetutat e padukshme 641, 643, 702, 763
kushtetutat e padukshme 762
kushtetutat e vendeve ish-komuniste 335, 584, 643
kushtetutat rigjide 472, 474
kushtetutat tranformative 335
kushtetutshmëri të përkohshme 714, 736, 737
Kuvajti 192
Kuvend i Ekspertëve të Iranit 203
Kuvendi i Algjerisë 206
Kuvendi i Kosovës 333, 355, 364, 439, 441, 463, 489, 498, 509, 529, 558, 635, 672, 673, 778, 792, 800, 805, 806, 807, 809, 845, 884
Kuvendi i KSAK 316, 318, 327, 376
Kuvendi i Malit të Zi 120, 121, 158
Kuvendi i Përkohshëm 308
Kuvendi i Përkohshëm Përfaqësues Popullor 308
Kuvendi i Popullit 36
Kuvendi i Republikës së Kroacisë 115
Kuvendi i RSFJ 317
Kuvendi Kombëtar 185, 189
Kuvendi Komunal i Prizrenit 443, 592, 676, 677, 941
Kuvendi Kushtetues 309, 313
Kuvendi Kushtetues 313

L

laiciteti 408, 639
LAJM 810, 947
Land 483, 745, 929
lander 58, 69
Laslo Syjom 641
law 21, 24, 25, 29, 39, 40, 59, 60, 61, 83, 155, 162, 163, 164, 169, 187, 206, 217, 219, 231, 233, 246, 249, 274, 289, 336, 372, 387, 399, 431, 436, 440, 491, 503, 549, 550, 552, 563, 564, 565, 568, 569, 574, 579, 580, 582, 583, 585, 598, 599, 618, 619, 621, 622, 627, 639, 640, 642, 643, 644, 648, 649, 651, 654, 655, 668, 669, 677, 683, 685, 686, 687, 688, 691, 693, 695, 696, 697, 698, 705, 719, 720, 768, 790, 825, 873, 894, 896, 898, 900, 902, 905, 906, 907, 908, 909, 911, 912, 913, 914, 915, 916, 917, 919, 921, 923, 925, 926, 928, 929, 931, 948, 950, 952, 953, 955, 956, 957, 958
LDK xviii, 327, 329, 379, 446, 447, 466, 467, 522, 794, 795, 796, 798, 800, 806, 810, 884, 956
Le Monde 508
Lech Garilcki 366
Legalizmi 259
leges 575
legjislatori negativ 419
legjislatori pozitiv 419, 480
lejueshmëria e kërkesës 570, 572, 604, 609, 615, 790
lëmi institucional 288
Leon Digi 66, 67
Leonid Nikitinsky 444, 916
les sages 515
Les Verts 759
letërkëmbimet 489, 505

Letonia/Latvia 50, 143, 292, 518, 540, 559, 562, 597, 619, 622, 649, 655, 774, 901, 904, 925, 948, 953, 956, 958
Letrat e Federalistit 84, 102, 232, 421
Lëvizja Vetëvendosje xviii, xix, 504, 544, 805, 814, 836, 884, 886
lex specialis 528
lex superior 38
leximi i gjerë i normës 671
leximi i ngushtë i normës 671
Libani 76, 78
liberalët e Frankfurtit 57
Libia 204, 209
Libri i Kaltërt 320
lideri suprem i Iranit 202, 203
ligje vitale 428
ligjet bazike 230, 231, 233, 235, 236
ligjvënia gjyqësore 622
ligjvënia konstante 579
ligjvënia negative 665, 700
ligjvënia pozitive 649
Lihtenshtajni 48, 518, 532, 562, 866
Lina Joy 255
Lindja e Largët 219, 220
Lindja e Mesme 220, 367
Liria e Asociimit 687
liria e asocimit 43
liria e shprehjes 461, 685, 690, 756
liria e vlerësimit 848
liria personale 62, 763
liritë fetare 288, 428, 654, 655
Lisbon Treaty 832
literatura italiane 393, 546
Lituania 77, 469, 559, 562
living constitution 643
living instrument 642, 643, 703
living law 668, 669, 705
Lochner Era 177, 687, 895, 906
Lochner vs. New York 177
Logoja e Prizrenit 476, 637, 776
lokean 83
London Tramways co. v. London County Council 582
Londra 25, 329, 693
Lord Bridge 695
Lord Bryce 471
Lord Mansfield 588
Louis Aucoin 352, 367, 917
Louis Favoreu 378, 450, 461, 490, 515, 594, 639, 769, 898
luajalitet institucional 775, 779
Lubjana 309
Lufta e Dytë Botërore 54, 851
Lufta e Ftohtë 111
Lufta e Parë Botërore 47, 56, 224, 307, 308, 309, 311, 326, 404, 622, 623, 841
Lufta Gjashtëditëshe 229, 230
Luftërat Ballkanike 307
Luksemburgu/Luxemburg 759, 841
lustrimi i figurave publike 554, 567
Lüth 464, 599, 689

M

Madagaskari 78, 502, 277
Magna Carta 771
Magna Charta e Perandorisë Otomane 223
Majlis 196, 200, 201, 203, 204
Majlis Al-Shoura 196
Makhzen 208
Malajzia, 126, 193, 253; shih dhe *Federata e Malajzisë*
Malcolm Simons 508
Malisheva 658
Malta 286, 532, 559, 562, 608, 727, 934
Mamatkulov and Askarov vs. Turkey 606
Manastiri i Deçanit x, 777, 791, 833, 834, 835
mandamus 237
Mandati i Palestinës 229
manipulimi 385, 743, 783
Manuel Crescencio Rejon 62
Maqedonia 121, 123, 293, 302, 401, 518, 559, 562, 596, 629, 822
Maqedonia e Veriut 121, 123
Marbury v Madison 46, 47, 48, 84, 232, 234, 617, 897

margin of appreciation 654, 655, 703, 846, 847, 848, 863, 887
margin of error 655
Mario Mendez 502, 503, 504, 918
Marokon 207
Marrëveshja e Beogradit 303, 304
Marrëveshja e Beogradit për USMZ 120
Marrëveshja e Brukselit 354
Marrëveshja e Dejtonit 113
Marrëveshja e Dejtonit 114, 331, 376, 486
Marrëveshja e Dytë 442, 819, 821, 822, 824, 825, 828, 829, 830, 885, 886
Marrëveshja e Korfuzit 307
Marrëveshja e Mastriht 593
Marrëveshja e Paqes 230, 334
Marrëveshja e Paqes me Egjiptin 229
Marrëveshja e Paqes me Jordaninë 230
Marrëveshja e Parë 442
Marrëveshja e Parë me Serbinë 422
Marrëveshja e Rambujesë 304, 330, 331, 332, 335, 339, 376, 586, 918
Marrëveshja e Vjenës mbi Trashëgimin e ish-Jugosllavisë 112
Marrëveshja e Zgjeruar 286
Marrëveshja mbi Parimet e Përgjithshme Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe 819
Marrëveshja mbi Trashëgiminë 820
Marrëveshja Parciale 286
Marrëveshja për BE 372
Marrëveshja për Paqe 113
Marrëveshja për Telekomunikacionin 825, 936
Marrëveshja Tito-Shubashiq 313
Marti Ahtisari 346, 348, 820, 821
Martin v Hunter's Lessee 85
masa e përkohshme 601, 602, 603, 604, 606, 608, 723, 780, 793
masat e emergjencës 481
Mauritania 78, 275, 277, 502
Mauro Cappelletti 25, 30, 38, 90, 170, 898, 919
Mauro Cappelletti and William Cohen 30, 38
Max Plank Institute 383
mbajtje preventive 736
Mbretëria e Arabisë Saudite 196, 197
Mbretëria e Jugosllavisë 311
mbulesa në shkolla 199
McCann et al. v. The United Kingdom 453
Meciar 512, 620
Mehmed Ali Pasha 199
Meksika 51, 62, 80, 165, 178, 189, 293, 503
members de droit 515
membres 515
memorandumet 499
Memorandumi i ASSHA 320
Memorandumi i Mirëkuptimit 676
Mendim i Përbashkët Mospajtues 795, 888, 957
mendim mospajtues 603, 615, 726, 768, 793, 794, 882, 883
mendime këshilldhënëse 395, 396
mendime këshilluese 840, 886
Mendimi i GJND për Kosovën 407
mesazhet 499
Mesjeta 581, 582
metafizike dhe e pabazuar 662
metoda e case-law 599
metoda e konstruktimit 578
metoda e tekstualizimit të precedentit 600
Michael Bourke 496
Michail Gorbacov 321
migracioni 847
Mihajl Gorbaçov 147
mikst 163, 164, 165, 180, 181, 183, 188, 683
Milovan Buzadzic 325, 899
Ministria e Drejtësisë 453, 676, 938
Ministria e Ndërtimit dhe Banimit xviii, 766
Ministria e Punëve të Brendshme 453, 676, 938
minoranca parlamentare 443
Misioni i EULEX 663, 844
Misioni i OSBE 468
mjetet juridike efektive 677
mjetet juridike 66, 114, 154, 241, 267, 280, 381, 449, 451, 452, 453, 454, 482, 491, 543,

658, 816, 849, 856, 869, 871, 876
mjetet nacionale juridike 451
modeli 26, 62, 65, 72, 74, 80, 87, 89, 90, 96, 107, 131, 145, 162, 164, 165, 167, 169, 172, 174, 178, 191, 194, 214, 219, 242, 255, 256, 269, 270, 273, 275, 276, 315, 361, 363, 364, 390, 395, 427, 428, 450, 481, 493, 502, 509, 542, 757, 784
modeli amerikan 25, 39, 50, 56, 59, 72, 75, 76, 81, 226, 263, 688, 725
modeli difuz 166, 168, 188, 396
modeli difuz 167, 169, 395
modeli francez 228, 277, 284, 514
modeli i bashkëpunimit. 509
modeli i caktimit të drejtpërdrejtë 494, 509
modeli i caktimit të drejtpërdrejtë 509
modeli i centralizuar 65
modeli i decentralizuar 457
modeli i koncentruar 162, 219
modeli i kontrollit kushtetues difuz 162
modeli i përzier 164, 180
modeli i përzier 26, 65, 72, 90, 164
modeli i përzier 63, 74, 164, 169
modeli i zgjedhjes 509
modeli i zgjedhjes 509
modeli i zgjedhjes 509
modeli kelsenian/evropian 44
modeli konsociacional 427, 428, 481
modeli konsociacional i demokracisë 428
Modestinus 578
modus operandi 619, 620, 622, 700, 737, 781, 830
Moladavia 77
Moldavia 134, 293, 465
Mongolia 78, 255, 256, 257, 282
mosdiskriminimi 332, 510, 629
Moska 154
mosshterja e mjeteve juridike 624, 658, 659
mosveprimi 92, 94, 95, 103, 252, 391, 394, 396, 427, 453, 712, 723
Mozambiku 335
Muhamedi 199, 202
Muhamer Gadafi 204
Mujtahid 201, 202
Muri i Berlinit 77, 131, 274, 288, 302, 312, 625
Musolini 48
Mustafa Kemal 224
mutatis mutandis 107, 414, 451, 452, 491, 534, 542, 554, 559, 606, 607, 635, 644, 649, 667, 668, 672, 678, 680, 699, 721, 725, 727, 731, 773, 843, 860, 868, 879, 886
mysliman 23, 28, 30, 54, 73, 76, 81, 208, 219, 253

N

Nacional-Socializmi 689
nacionalistët kinezë 259
Napoleon Bonoparte 41
Narodne Novine 439, 958
Naser Gjinovci 726
natyrë absolute 431, 435, 436, 546, 845
natyrë dialoguese 759, 771
natyrë ekstra-juridike 619, 700
natyrë juridike 28, 60, 69, 152, 162, 163, 165, 182, 212, 316, 340, 350, 399, 416, 447, 465, 500, 506, 508, 554, 577, 615, 646, 657, 709, 710, 711, 716, 719, 729, 730, 815, 819, 826
natyrë juridike-kushtetuese 700
natyrë njerëzore 434
natyrë rrethanore 625
natyrë subsidiare 853
Nazizmi 789
ndalimi i torturës 433, 654
ndalimi i veprimit retroaktiv të normës juridike 626
ndarja dhe balancimi i pushtetit 29, 656
ndarja vertikale e pushteteve 636
ndërtimi i normave 419, 549
ndryshimi rrënjësor i identitetit kushtetues të shtetit 636
ne bis in idem 626, 718, 859
në vakum 415
Nga një dhjetor në tjetrin 151
ngurtë 453, 471, 692, 853
Nigeri 275, 277, 502

Nikaragua xvi, 59, 60, 164, 167, 171, 172, 178, 335
Nikola Sarkozi 348
Nikolla Pashiq 307
niqabi 200
nivele lokale 681
Nobel 346
nomos 36, 37
non liquet 849, 881, 882
non-liability 534, 540
norma etike 663
norma/ligji është i paaplikueshëm 728, 781
norma/ligji është i pavlefshëm 728, 781
norma/ligji më nuk është në forcë 781
normave të vetekzekutueshme 337, 587, 613
normavënie implementuese 826
normëvënie 646, 650, 654, 656, 666, 669, 671, 672, 707
normëvënie ekstra-parlamentare 646
normëvënies implementuese 824, 825, 885
Norvegjia 47, 60, 97, 103, 286, 465, 518, 532, 540, 559
notat 382, 499
notat verbale 499
Novella 882
nulla pene sine lege 433
nullum crimen sine lege 433

O

obiter dicta 571, 572, 573, 672, 722, 723, 724, 725, 780
obiter dictum 474
objekte politike 679
objekteve të caktuara politike 681
Objekti i çështjes 441, 544, 635, 663
objekti i çështjes 609, 838, 854
objekti i interpretimit 393, 394, 394
objektiv teleologjik 278
objektive 34, 66, 69, 274, 365, 369, 505, 506, 513, 514, 515, 518, 519, 520, 521, 522, 531, 545, 546, 563, 566, 625, 627, 654, 674, 682, 697, 707, 718, 755, 762, 849, 852
Oliver Kromvellit 73
Oliver Wendell Holms Jr 617
Omani 193, 195
Ombudsperoni i Kosovës 412
Ombudspersoni i Dhomave të Specializuara 413
Omer Hamzić 302, 899
ometimi 406
ometimi legjislativ 156, 650
on par 821
one line single conclusive argument 773, 786
only for compelling reasons 87
operacioni silogjistik 653, 768
opiniondhënës 448
order public 401
organi kushtetutëbërës 469
organike 165, 182, 206, 207, 209, 210, 216, 229, 249, 250, 265, 281, 362, 421, 439, 462, 463, 464, 470, 473, 480, 487, 488, 519, 536, 547, 566, 709, 733, 744, 791, 792, 840
originaire 351, 352, 353, 356, 357, 359, 361, 493, 803, 804, 883, 905
origjinal 58, 70, 75, 86, 93, 102, 171, 173, 174, 179, 182, 226, 254, 256, 270, 283, 332, 352, 353, 357, 359, 360, 361, 365, 366, 368, 381, 414, 419, 439, 440, 469, 470, 471, 472, 473, 474, 475, 480, 482, 493, 600, 617, 618, 640, 642, 649, 665, 683, 685, 704, 737, 746, 750, 782, 803, 813, 826, 827, 830, 836, 859, 860, 866, 867, 877, 897

P

pacta sunt servanda 504, 824
pakica në parlament 444, 445
Pakistani xv, 201, 221, 898, 908, 932, 945, 955
Pakti Fundamental 210
pala ka hequr dorë 451
palë e autorizuar 122, 148, 149, 235, 241, 252, 273, 279, 412, 423, 424, 441, 450, 636, 795, 830
palë të privilegjuara 140, 422, 830
Palestina 229
Panama xvi, 59, 64, 164, 172, 178, 931
papajtueshmëria 156, 518, 519, 566

Papinian 578
paraburgimi preventiv 736
paradoksi i konstitucionalizmit 364
paradoksi kushtetues 374
Paraguaji 59, 172
parametrat 47, 89, 203, 215, 221, 319, 327, 342, 369, 373, 374, 380, 399, 438, 462, 463, 476, 479, 501, 519, 532, 535, 610, 619, 624, 631, 638, 639, 641, 643, 648, 653, 656, 664, 670, 672, 700, 701, 702, 716, 750, 751, 793, 811, 812, 841, 850, 852
parametrat që përdoren për interpretim 393
parimet dhe dispozitat e paamendamentueshme kushtetuese 474
parimet kemaliste 224
parimet të kemalizmit 224, 226
parimet themelore të kemalizmit 225
parimi i efektivitetit dhe i interpretimit meta-teleologjik 757
parimi i interpretimit autonom të termave 758
parimi i legalitetit 588, 626
parimi i lirisë së vlerësimit 847
parimi i mosdiskriminimit 432
parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve 628, 656, 839
parimi i prezumimit të kushtetutshmërisë 666, 667, 728, 741, 781
parimi i prezumimit të kushtetutshmërisë së normës që ka kaluar testin e vlerësimit të kushtetutshmërisë nga gjykata përkatëse kushtetuese 733
parimi i proporcionalitetit 431, 436, 654, 689, 690
parimi i subsidiaritetit 622, 668, 669, 705, 758, 846, 847, 865, 887
parimi i vlerësimit të lirë 654, 846, 887
parimi kushtetues i barazisë 750
Parisi 332
Parlamenti 51, 76, 99, 100, 126, 128, 140, 141, 146, 155, 156, 268, 273, 439, 448, 546, 562, 691, 695, 735, 762, 763, 764, 785
Parlamenti Britanik 24, 40, 694, 695, 696, 707
Parlamenti i Anglisë 552
Parlamenti i Austrisë 49
Parlamenti i Britanisë së Madhe 24
Parlamenti i Francës 687, 761
Parlamenti i Hungarisë 126, 691
Parlamenti i Izraelit 764, 785
Parlamenti i Kanadasë 735
Parlamenti i Mongolisë 256
Parlamenti i Palestinës 230
Parlamenti i Republikës Autonome të Krimesë 155
Parlamenti i Rumanisë 141, 448
Parlamenti i Ukrainës 155, 156
Parlamenti i Ukrainës 156, 562
Parlamenti i Japonisë 269
Parlameti i Rusisë 150
Partia Demokratike e Kosovës xviii, 520, 523
Partia e Ataturkut 225
Partia e Nacionalistëve të 265
Partia Komuniste e Kinës 261
Partia Komuniste Jugosllave 107, 314
Partia për Zhvillim dhe Drejtësi 225
partia shtet 264
Partial Agreement 285
Pasaporta 706
pasiviteti gjyqësor 651, 703
Paulus 578
pavarësia institucionale 529
Peder Carl Lasson 97
pengesat procedurale kushtetuese 474
per definitionem 536
Perandoria e Kinës 259
Perandoria Osmane/Otomane 200, 224, 326, 818
Perandoria Romake 575
Perestrojka 143
përjashtimi i gjyqtarit 546
përjashtimi në rrethanat e domosdoshmërisë 548
përsëritja e procedurës x, 845, 848, 855, 861, 862, 866, 867, 873, 874, 876, 877, 878
Peru 60, 62, 74, 75, 161, 164, 172, 285, 642, 905

petituimi 659
Petri i Dytë Karagjorgjviq 313
Petri i Parë 308
petrifikimi 755
Plani i Ahtisaarit 820
Plani Urbanistik 676, 677
Platoni 38
Pol Pot 220
Policia e Kosovës 345, 530
Polonia vii, 72, 77, 78, 93, 106, 125, 129, 257, 258, 307, 502, 503, 509, 518, 559, 562, 642, 729, 738, 781, 827, 895, 905, 906, 917
pontifices 575
Portugalia 60, 72, 73, 89, 90, 169, 258, 286, 335, 388, 490, 502, 503, 515, 518, 559, 562, 596, 618, 652, 688, 790
post-festum 498, 681
pouvoir constituant derive 493
pouvoir constituant originaire 351, 352, 353, 356, 357, 359, 493, 804
pouvoir neutre et intermediaire 70, 71
pouvoirs constituant 352, 493, 821
power devolution 696
power devolution laws 696
pozitivizmi 404, 578, 689, 790
Pranvera Arabe 211
Pranvera e Pragës 58
precedentët e zgjidhjes 571
precedentët gjyqësorë 45, 697
precedentët të huaj 77
precedenti 41, 96, 103, 175, 451, 574, 580, 581, 582, 583, 590, 600, 601, 607, 611, 614, 615, 647, 660, 662, 697, 713, 717, 719, 722, 754, 758, 763, 778, 838, 852, 856, 862, 865, 868, 872, 882
precedenti në kuptim të gjerë 588
precedenti në kuptim të ngushtë 588
precedents of interpretation 571, 612
precedents of solution 571, 612
premisa e poshtme 624, 701
premisa e poshtme 624, 768
premisa kelseniane 504
premisa major 392, 611, 624, 701, 758, 761, 768, 853
premisa minor 391, 624, 701, 758, 761, 768
President Jahjaga 506
Presidenti i Kosovës 384, 466, 468, 470, 489, 496, 497, 498, 507, 531, 567, 595, 633, 634, 661, 663, 664, 699, 722, 794, 798, 800, 801, 843
Presidenti i Rajhut 58
presidiumi 107, 314
Presidiumi i Sovjetit Suprem 143
preventiv 33, 42, 43, 47, 62, 75, 86, 92, 93, 94, 95, 98, 100, 103, 124, 132, 140, 142, 149, 155, 159, 182, 184, 185, 205, 206, 207, 209, 210, 211, 212, 213, 216, 219, 242, 244, 245, 246, 269, 275, 277, 280, 314, 396, 420, 438, 442, 443, 465, 466, 467, 468, 469, 475, 490, 496, 502, 503, 507, 596, 666, 669, 687, 734, 736, 762, 778, 800, 827, 840, 843, 885, 887
prezumimi i kushtetutshmërisë së ligjeve 622, 664, 666, 704, 705, 812
prezumimi për lejueshmërinë e kërkesës 609
prezumimi procedural 651
prima facie 359, 400, 403, 405, 602, 603, 604, 605, 615
principaliter 87, 88, 89, 92, 93, 94
principo dispositivo 769
Prishtina xiii, xvii, 51, 106, 111, 113, 304, 316, 328, 354, 362, 374, 379, 381, 382, 393, 397, 398, 406, 407, 408, 409, 413, 417, 430, 442, 443, 446, 450, 451, 454, 456, 458, 461, 463, 464, 492, 495, 496, 497, 500, 502, 506, 507, 511, 520, 530, 531, 532, 535, 543, 544, 545, 548, 553, 557, 558, 560, 568, 569, 572, 575, 592, 594, 595, 596, 597, 604, 605, 630, 631, 632, 633, 634, 635, 636, 637, 638, 644, 645, 647, 656, 658, 660, 661, 662, 665, 668, 673, 674, 676, 678, 709, 712, 714, 718, 722, 724, 726, 732, 738, 742, 776, 777, 778, 790, 791, 792, 798, 803, 807, 811, 820, 826, 829, 838, 855, 856, 857, 858, 860, 869, 882, 888, 894, 895, 896, 897, 900, 912, 922, 930, 931, 934, 935, 936, 937, 938, 939, 940, 941, 942, 943, 944, 945, 949, 954, 957
privatizimi 356, 357, 358, 360, 377, 652, 748, 783, 802, 803, 804, 805, 834, 835
privilegjet 406, 444, 507, 518, 527, 531, 544, 566, 699, 845
Privy Council 187, 693

pro futuro 88
procedura 26, 27, 42, 59, 64, 87, 89, 114, 124, 129, 132, 136, 137, 141, 156, 165, 214, 236, 237, 250, 254, 258, 262, 267, 277, 322, 324, 364, 365, 374, 380, 423, 443, 469, 471, 478, 482, 489, 492, 500, 509, 518, 519, 526, 532, 533, 536, 537, 538, 542, 544, 545, 546, 548, 555, 556, 557, 563, 564, 565, 567, 597, 601, 602, 621, 658, 660, 669, 676, 678, 704, 710, 711, 722, 727, 730, 731, 732, 742, 747, 794, 796, 834, 835, 837, 845, 849, 855, 856, 857, 858, 862, 863, 864, 866, 867, 869, 871, 876, 879
procedura e amendamentimit të zakonshëm 469
prodhimet dhe refleksionet mendore 706
profesionale xiii, 42, 226, 263, 271, 359, 383, 384, 385, 470, 487, 488, 516, 517, 518, 520, 521, 541, 558, 566, 567, 593, 597, 640, 690, 699, 740, 763, 792, 804, 822, 830, 843, 844, 865, 886, 887, 955
Prokuroria Publike 344
pronësia 121, 367, 461, 652, 742, 783, 834, 860, 862, 872
Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës 2 shkurt 2007 304
psefisma 36, 37
pseudo-silogjizëm 761
publiku 146, 384, 446, 552, 594, 648, 761, 810
puçi 74, 182, 564, 565
pushteti konstituiv 418, 493, 628, 629, 637, 638, 640, 641, 643, 650, 701, 702, 804
pushteti konstituiv derivativ 628, 629, 638, 701, 702
pushteti konstituiv origjiner 701
pushteti kushtetutbërës 399
pushteti më pak i rrezikshëm 84
putinizimi 832
puvoir neuter et intermediare 71

Q

Qajar 200, 201
qasja e tërthortë në gjykatë 456, 482
Qazim Qeska 398, 592, 631, 632, 829, 930, 943
Qeveria 58, 76, 93, 150, 162, 225, 259, 266, 268, 307, 309, 354, 363, 372, 389, 398, 411, 422, 423, 424, 425, 426, 431, 435, 436, 440, 450, 463, 466, 478, 479, 480, 481, 482, 491, 522, 528, 531, 532, 535, 536, 592, 632, 634, 636, 638, 644, 645, 646, 647, 656, 668, 673, 799, 810, 819, 821, 828, 829, 830, 832, 834, 838, 839, 884, 886, 937, 938, 943, 945
Qeveria e Kosovës 381, 398, 430, 645, 646, 668, 806, 810, 825, 930
Qeveria e Kumintang 266
Qeveria e Mbretërisë së Serbisë 307
Qipro 25, 49, 72, 286, 592
Question prioritaire de constitutionnalité 744
qytet-shtetet greke 35
qytet-shteti kretian 36

R

Raad van State 101
radio decidendi 599, 604
Raiffeisen Bank 464, 791, 811, 938
Rambuje 330, 331, 332, 334
Ramush Haradinaj 810
Raporti Dick Marty 631
Raporti mbi të Drejtat e Joshtetasve dhe Pakicave 596
rasti gjerman 401, 736, 830, 840, 886
rasti i AKP 791
rasti i Asociacionit Serb 632, 638, 791, 838
Rasti i distrikteve elektorale II, BVerfG 16, 130 736, 937
rasti i Ferizajt 777
rasti i Gjykatës Speciale 660, 704
rasti i imunitetit 415, 558, 559, 674, 699
rasti i KQZ 792
rasti i Kryeprokurorit të Shtetit 706
rasti i ngërçit 883
rasti i Pensioneve të Deputetëve 665, 705
rasti i pensioneve të FSK-së 634, 702
rasti i Presidentit Thaçi 704
rasti i qarkores qeveritare 644, 703
rasti i Radio Televizionit të Kosovës (RTK) 603, 790

rasti i rrogave 553, 644, 703, 792
rasti i tentim-rrënimit të Gjykatës Speciale 792, 887
rasti i tentimit për shkarkim me amendamente kushtetuese të shefit të shtetit në Kosovë 800
rasti i ushtruesit të detyrës së Presidentit të Republikës 633
rasti i Veteranëve 673, 705
rasti i zgjedhjes së Presidentit H. Thaçi 791
rasti Jahjaga 463, 464, 466, 791
rasti Mensalão 685
rasti Pacolli 699
rasti Pasaportat 676, 706
rasti Qeska 829, 886
rasti Sejdiu 790
rasti Trepça 674
rasti VLAN 632, 791, 883
ratifikimi i brendshëm 819, 824, 827, 885
ratifikimi ndërkombëtar 824
ratio decidendi 571, 582, 583, 584, 589, 590, 591, 596, 599, 601, 614, 724
ratione loci 403, 405, 838
ratione materiae 403, 405, 422, 632, 633, 636, 656, 792, 831, 838, 848, 849, 854, 855, 858, 859, 860, 861, 863, 864, 867, 868, 869, 871, 875, 879, 881, 882
ratione personae 403, 405, 422, 838
ratione temporis 379, 380, 381, 382, 403, 405, 454, 478, 838
ratus 824
reading down 693, 694, 735
reading in 693, 694, 735
realizmi legal 617, 618, 622, 700
Reçaku 330
Recep Tayyip Erdoğan 225
recurso de amparo 62
recurso de casacion 62
recusazione 546
referendumi 111, 116, 118, 134, 141, 147, 226, 288, 362, 427, 428, 448, 472, 761, 762, 797, 947
referendumi nacional 656
remonstrance 40
rend objektiv juridik 34, 690
rendi objektiv juridik-kushtetues 653
Renesanca 578
Republika Autonome Ajaria 138
Republika Autonome Nakhchivan 240
Republika Dominikane 59, 60, 164, 502
Republika e Afrikës së Jugut 271
Republika e Armenisë 135
Republika e Azerbajxhanit 239, 240
Republika e Bosnjë-Hercegovinës 111
Republika e Çekisë 77
Republika e Gjeorgjisë, 137
Republika e Kosovës 360, 363, 373, 389, 451, 497, 500, 501, 505, 543, 557, 587, 588, 718, 726, 922, 937, 959
Republika e Kroacisë 111
Republika e Malit të Zi 111, 118
Republika e Maqedonisë 111
Republika e Moldavisë 138, 139
Republika e Pestë 205, 687
Republika e Qipros 49
Republika e Serbisë 302, 305, 330, 333
Republika e Serbisë 303, 322
Republika e Sllovakisë 132
Republika e Sllovenisë 323
Republika e Turqisë 222, 223, 224, 435
Republika e Turqisë 49
Republika e Uzbekistanit 247
Republika e Vajmarit 404
Republika e Vajmarit 69, 689
Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë xix, 301
Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë xvii, 108, 109, 350
res intepretationis 607
res judicata 390, 555, 584, 588, 589, 590, 607, 613, 709, 711, 714, 717, 718, 719, 720, 722, 723, 731, 732, 746, 778, 779, 780, 787, 833, 835, 886
reserves constructives 670
réserves d'interprétation 670, 948
reserves directives 670
reserves neutralisantes 670
rest interpretata 714

restitucio in integrum 878
revidimi rrënjësor kushtetues 638
Revolucioni Borgjez Francez 71
Revolucioni Francez 40, 50, 459, 639, 852
Revolucioni i Famshëm 102
Revolucioni i Lavdishëm 38, 39
Revolucioni i Tetorit 585
Revolucioni Kulturor 262, 263
revolucioni kushtetues 233, 235, 764, 786
Revolucioni Madhështor i Anglisë 44
Rexhep Taip Erdogan 194, 225, 226, 435, 564
Rezoluta 1244 120, 304, 332, 338, 339, 340, 341, 345
Rezoluta Harari 231
Riadi 194, 196
Riigikogu 99
Riksdagu 98
Rimandatimet e reja 500
rime obbligate 743, 744
Ristrukturimi 143
Riza Smaka 384, 467
Robert Carolan 305, 385, 485, 488, 495, 496, 502, 504, 507, 508, 511, 543, 544, 545, 548, 552, 553, 555, 556, 557, 558, 559, 560, 567, 799
roli këshilldhënës 391
roli nomifolaktik 396
Roma 35, 37, 575, 612
Ron Hogimestra 496
Rrafshnalta e Golanit 229, 230
rregulla mbi domosdoshmërinë 554
Rregullorja 1999/24 337
Rregullorja e Punës (RP) 487, 725, 776
Rregullorja e Punës së Gjykatës Kushtetuese 619
Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12 359
Rregullorja për AKM 358
rrethana objektive 519
rreziku ekzistencial për jetën e shtetit 429
Rripi i Gazës 229, 230
rruga Perandori Justinian, 382
Rubikon 466
Rudolf Smend 464, 689
Rumania 77, 134, 140, 142, 258, 502, 509, 514, 518, 540, 559, 562
Rusia 77, 134, 143, 146, 149, 150, 160, 256, 293, 307, 324, 326, 332, 348, 349, 502, 518, 559, 832, 841; shih dhe *Federata e Rusisë*
Rusia Cariste 143, 326
Ruti Teitel 305, 362, 473, 627, 678, 922

S / Sh

Saar 522, 735, 909
Saarstatut 735, 937
Sabori 439
Sabri Hamiti 445, 595, 660, 722, 742, 791, 798, 799, 836, 837, 943
saisine d'office 277
Sala Constitucional 175, 176
Salazar 73, 743, 751, 922
Samaria 230
Sami Kurteshi 504, 544, 558
Samuel Huntington 275
San Francisko 325
Sao Tome & Principe 275
Saudi 194, 196
Savigny 554, 578, 579, 698, 708, 723, 904, 905
Scordino v. Italy 453
Scuola Grande di San Giovanni Evangelista 285
secesioni 325, 355
Sejm 129
Sekretari i Përgjithshëm i OKB 334, 345, 346, 558
Selvete Gerxhaliu 508
Senati 61, 162, 542, 564, 652
Senati Amerikan 542
Senati Francez 761
Senati i Holandës 101
Senati i Romës 652
Senati Konservator 61
Senegali 78, 275, 277, 502
Senezhana Botusharova 508
sentenca interpretativa di rigetto 669

sentence interpretative di rigetto 741, 783
sentence manipolative 742, 783
sentenza interpretativa di accoglimento 641, 669, 740, 782
sentenze additive 744
sentenze additive di principio 744
sentenze di correzione 669
sentenze interpretativa di accoglimento 740
sentenze monito 751
sentenze sosituive 741, 743, 782, 783
Serbi-Mali i Zi 302, 820
Serbia xix, 111, 112, 113, 118, 119, 120, 121, 123, 125, 143, 151, 257, 293, 301, 302, 319, 320, 321, 322, 325, 327, 330, 331, 348, 349, 355, 437, 501, 503, 629, 824, 827, 896, 909, 917, 951
Serbia e Madhe 307
Serbia e Millosheviqit 330
seriatim 755, 756
Sharl de Goll 208, 216
SHBA vii, viii, xvii, xix, 21, 22, 25, 26, 30, 33, 34, 39, 40, 44, 45, 47, 51, 53, 56, 57, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 67, 68, 73, 74, 80, 83, 84, 85, 86, 89, 90, 94, 102, 111, 113, 131, 161, 162, 163, 165, 166, 169, 170, 173, 176, 177, 186, 187, 188, 221, 229, 232, 234, 235, 309, 332, 349, 351, 395, 396, 400, 410, 415, 417, 457, 473, 474, 479, 480, 491, 495, 503, 515, 516, 523, 534, 540, 541, 542, 548, 549, 550, 552, 553, 554, 556, 563, 564, 574, 575, 582, 594, 595, 617, 618, 622, 626, 641, 651, 654, 683, 686, 687, 693, 701, 771, 772, 813, 819, 839, 842, 851, 853, 910
Shefi i Shtetit 196, 531, 634, 702, 819, 826
Sheriati islam 193, 194, 196, 197, 201, 221, 253, 254, 255
shkelja e supozuar direkte nga akti i përgjithshëm 453
shkelja kushtetuese x, 124, 140, 403, 406, 448, 455, 477, 504, 557, 669, 699, 709, 727, 728, 731, 737, 781, 782, 805, 813, 856, 857, 873, 883
shkelja serioze 446
shkelja serioze kushtetuese 447, 448
shkeljet nga autoritetet publike 449, 492, 849
shoqëritë në trancizion 652
shoqëritë post-revolucionare 652
shtet gjyqësor 68
Shteti i Kosovës 355, 718, 742
shteti laik 254
shumica e caktuar parlamentare 232, 279
Sierra Leone 487
sigurimi shëndetësor 527
silogjistik 653, 758, 762, 768
silogjizëm i ngurtë 853
silogjizmi 26, 574, 624, 686, 701, 852, 853
silogjizmi gjyqësor 574, 686, 701
Simon Bolivar 61
Sinai 229
sine qua non 22, 131, 431, 527
Singapori 253
Sir Edward Coke 24, 626
Siria 193, 209
Siria 75, 229, 230
sistem semi-presidencial 664
sistemi amerikan 63, 80, 83, 84, 88, 90, 94, 95, 96, 98, 102, 103, 142, 163, 166, 173, 269, 395, 491, 540, 541, 548, 654, 685
sistemi civil 573
sistemi difuz 164, 171, 189, 491
sistemi gjysmë-presidencial 664
sistemi i centralizuar 99
sistemi i përzier 27, 169, 183
sistemi i qeverisjes 86, 227, 367, 492, 664
sistemi i së drejtës së përgjithshme 83, 162, 163, 169, 187, 219, 253, 271, 491, 515, 530, 563, 565, 573, 574, 580, 582, 588, 595, 599, 610, 651, 727, 734, 735, 781, 813, 814, 853
sistemi kontinental 163, 169, 276, 563, 651, 706, 727, 735, 852
sistemi nacional gjyqësor 197, 289
sistemi politik italian 707
Skandinavia 22
Skocia 581, 696
Sllobodan Milosheviq xvi, 304, 319, 322
Sllovakia 77, 130, 132, 159, 411, 502, 518, 559, 562, 592, 841
Sllovenia 302, 323, 502, 518, 540, 559, 592,

596, 629, 639
Snezhana Botusharova 488, 502, 795, 957
soft law 583, 677
sovjeti suprem 242
Sovjeti Suprem i Rusisë 146
sovjetik 129, 134, 137, 138, 143, 144, 145, 151, 198, 238, 239, 241, 242, 244, 245, 255, 256, 314, 581, 639
Spanja 48, 59, 72, 74, 272, 286, 335, 388, 401, 490, 502, 509, 514, 515, 518, 562, 618, 652, 682, 688, 697, 729, 745, 746, 751, 768, 781, 784, 790
Staatsgerichtshof xix, 58, 59, 68, 69, 70, 688
Stalini 312
Standardet para Statusit 337, 338, 349
Standardet për Kosovën 338
stare deceisis 721
status quo ante 735
Statuti 286, 296, 316, 355, 441, 442, 443, 605, 608, 769, 821, 884
Statuti i GJND 355
statuti komunal 426
Strasburgu 150, 285, 381, 409, 521, 569, 570, 589, 606, 611, 655, 669, 748, 757, 780, 785, 822, 841, 846, 852, 853, 860, 862, 864, 866, 867, 872, 873, 875, 877, 878, 880, 949, 953, 955
stricto sensu 430, 759, 760, 785
struktura argumentuese dialoguese 767, 769, 770
struktura argumentuese jo-zinxhirore 767
struktura dialoguese/diskursive 772
struktura e argumenteve kushtetuese me argumente të përdorura paralelisht 753, 854, 855
struktura e argumenteve kushtetuese me një rresht 753, 754, 755, 769, 855
struktura e argumenteve reciprokisht përjashtuese por kumulativisht kuptimplote 725
struktura e argumentit këmbët e karriges 855
struktura e përzier argumentuese 770
struktura lineare argumentuese 838, 854
struktura zinxhirore lineare 765, 786
sua sponte 109, 125, 139, 154, 316, 317, 326, 328, 376, 393, 421, 456, 509, 510, 540, 621, 666, 835
sub iudicio 169
subjektiv teleologjik 278
subjektivi 64, 109, 350, 505, 506, 521, 522, 546, 566, 623, 627, 628, 653, 718, 768
subsidiariteti 848
substanciale 67, 125, 128, 159, 179, 233, 234, 266, 303, 319, 331, 348, 366, 367, 395, 433, 445, 446, 454, 470, 471, 472, 473, 627, 639, 640, 696, 762, 764, 859
Sudani 193
Suedia 60, 103, 286, 532, 559, 562
Suharto 248
sui generis 111, 112, 144, 151, 348, 361, 387, 509, 759, 760
Sukarno 248
Sulltan Abdylhamiti II 200, 215, 224
sumula 174, 188
sundimi i ligjit 77, 79, 81, 115, 121, 146, 192, 244, 288, 291, 338, 430, 590
supendimi 431
super-kushtetues 613, 764
super-legjislativ 586, 613
Surinam 181, 185, 189
suspendimi 146, 375, 433, 436
Syndicat General 42
Systematic Thesaurus 291, 294

T / Th

ankesa e plotë kushtetuese 160, 400, 479, 675
Taivani 220, 264, 266, 268, 282, 769
Tajlanda 78
Task-Forca 410
Task-Forcë për Hetime Speciale 410
Taxhikistani 280
të decentralizuar 26, 27, 30, 62, 63, 78, 81, 84, 89, 90, 94, 164, 165, 166, 167, 168, 169, 170, 188, 219, 224, 251, 395, 396, 457
të mundshëm dhe efektiv 453
të reja dhe faktike kushtetuese 419
teknika legalistike 772
teknikat e interpretimit konform-kushtetutës 664, 669, 670, 704, 705

teknikat e tjera të interpretimit 622
teleologjik 278, 426, 437, 440, 462, 640, 684, 686, 693, 697, 698, 708, 755, 757, 758
Teoria kushtetuese 71, 91
teoria moniste 828, 831
testi i proporcionalitetit 429, 430, 431, 673, 674, 762
the CODICES database 289
The Common Law 618
the least dangerous branch 84
the Venice Forum 289
thema decidendum 728, 766, 769, 781
themeltësia e kërkesës 609
Thëniet dhe Veprat e Profetit Muhamet 196, 197, 199
Thesaurus 291, 294
Thomas Jefferson 640, 925
Thorbjorn Jagland 286
Tipi i plotë 281, 370, 790
Tito 303, 313, 319, 320, 321
Tito Shubashic 303
Tom Ginsburg and Rosalin Dixon 30
Tomabechi v. Japan 269
Tomë Krasniqi 305, 453, 455, 456, 603, 665, 726, 790, 793, 794, 938, 939, 957
Tomë Krasniqi v. RTK 453, 455, 456
Toni Honore 578
tradita civile 162
tradita koloniale britanike 396
Traite de droit constituionel 66
Traktati i Fezit 207
Traktati i Lisbonës 827
Traktati i Romës 695
Tregtari i Venedikut 571
TRIBUNA 810, 947
Tribuna shqiptare 384, 958
Tribunal de Cassation 41
Tribunal des Conflict 274
Tribunali Kushtetues 93, 183
Tribunët 61, 162
Tribunët romakë 37
Trinidad dhe Tobago 186, 187
Trojka 349
Tudor 40
Tumey v. Ohio 549, 945
Tunisia 192
Turkmenistani 238
Turqia viii, 49, 72, 73, 126, 220, 222, 279, 286, 326, 388, 465, 503, 518, 559, 562
Turqit e Rinj 224

U

UÇK xix, 306, 319, 327, 329, 332, 465, 673, 674
Udhëtimet e Guliverit 571
Uells 696
Ukraina 77, 134, 154, 157, 293, 465, 509, 518, 540, 559
Ulpiani 577
ultra petitum 456
ultra vires 621, 634, 676, 689, 798, 827, 832
unconstitutional constitutional amandements 474
unechte 450
Unioni Serbi–Mali Zi xix, 116, 119, 120, 158, 302, 304, 323, 375
United Mizrachi Bank v. Migdal Cooperative Village 232, 233, 234, 235, 279
Uniteti politik i popullit 467
UNMIK xix, 303, 305, 331, 337, 338, 339, 340, 341, 342, 343, 345, 346, 347, 349, 350, 356, 357, 358, 359, 360, 377, 488, 586, 596, 665, 682, 802, 803, 804, 805, 820, 821, 834, 938, 944
urdhrat 181, 237, 262, 575, 606, 716
Urdhrat e Islamit 201, 221
urdhrat pretoriane 577
ushtarako-politik 83
USMZ (shih *Unioni Serbi–Mali i Zi*)
Uzbekistani xvii, 238, 240, 241, 246, 247, 248, 904, 932, 934

V

Vajmari xviii, 25, 47, 48, 55, 58, 69, 71, 80, 131, 404, 431, 465, 474, 584, 594, 623, 689
vala e tretë e demokratizimit 275
Valentinian 578
Van Gend en Loos 760

Van Oosterwijck v. Belgium 452
velayat-e faqih 204
Vëllazëria Muslimane 198
vendet arabe vii, 54, 65, 72, 76, 77, 78, 81, 195
vendet e Azisë Qendrore viii, 238, 280
vendet e tjera afrikane 273
vendet islamike 23, 50, 134, 191, 192, 193, 194, 196, 475, 639
vendet komuniste 72, 78, 105, 238, 287, 366, 403, 448, 516, 542, 567, 584, 620, 819
vendet myslimane 23, 28, 30, 76, 81
vendet që janë të garantuara 517
vendet turkike 239
vendimet e gjykatave kushtetuese 397, 480, 583, 595, 596, 709, 720, 723, 727, 734, 747, 778, 779, 780, 781, 783
vendimet e mëdha 384
vendimet jomeritore 661, 838
vendimet këshilluese 840
vendimet këshilluese 841, 842
vendimet që gjejnë shkelje kushtetuese 727
vendimet që nuk gjejnë shkelje kushtetuese 727
vendimi 42, 43, 47, 48, 56, 63, 69, 70, 83, 93, 111, 114, 124, 128, 136, 140, 141, 142, 145, 149, 156, 157, 174, 180, 182, 185, 189, 211, 234, 257, 269, 273, 279, 282, 292, 313, 316, 317, 324, 344, 351, 352, 353, 357, 359, 365, 377, 384, 398, 402, 406, 407, 408, 410, 415, 416, 424, 426, 430, 431, 432, 439, 442, 443, 444, 445, 446, 447, 448, 449, 451, 452, 456, 458, 460, 461, 466, 474, 477, 479, 481, 486, 488, 492, 495, 502, 503, 511, 514, 524, 531, 536, 537, 539, 541, 543, 545, 546, 547, 548, 552, 553, 556, 560, 562, 564, 573, 574, 577, 589, 590, 591, 593, 594, 595, 596, 597, 599, 600, 601, 603, 605, 610, 614, 615, 626, 629, 634, 635, 639, 644, 645, 646, 647, 651, 654, 656, 657, 658, 659, 660, 661, 662, 665, 667, 668, 670, 676, 677, 691, 704, 705, 706, 709, 712, 714, 716, 717, 718, 719, 721, 722, 723, 724, 725, 728, 729, 730, 732, 733, 734, 735, 736, 737, 738, 739, 742, 744, 745, 746, 747, 748, 750, 751, 753, 757, 758, 759, 761, 763, 764, 766, 769, 770, 776, 778, 779, 783, 784, 786, 787, 790, 791, 792, 793, 794, 796, 800, 802, 806, 808, 812, 815, 818, 830, 833, 834, 837, 838, 840, 841, 852, 855, 859, 861, 862, 863, 864, 865, 866, 867, 868, 869, 871, 872, 873, 875, 876, 877, 878, 879, 880, 881, 884, 886, 933
vendimi meritor 398, 460, 466, 479, 573, 614, 647, 657, 659, 662, 665, 676, 704, 706, 714, 721, 732, 790, 792, 812, 830, 838
vendimi që konstaton se norma/ligji i kontestuar është në pajtim me kushtetutën 728
Venediku 33, 37, 444, 571
Venezuela 59, 60, 63, 106, 126, 164, 166, 167, 172, 502
Versajë 307, 309, 311
vështirësia kundërmazhoritare 363, 648
vetëpërjashtimi 544
vetëpërjashtimi 548
vetëpërjashtimi i gjyqtarit 567
vetëpërjashtimi nga rasti 507, 543
vetëpërmbajtja 621, 666, 671, 672, 674, 675, 706
vetëpërmbajtja gjyqësore 621, 666, 671, 672, 674
vetëqeverisja lokale 116, 120, 121, 122, 124, 125, 132, 136, 243, 309, 316, 330, 339, 408, 426, 440, 441, 442, 476, 478, 483, 656, 701
vetëvendosja 355
vetingu 152, 554, 567, 659
vetingu shqiptar 152, 554, 567
Vietnami 134
Vijayanathan & Pusparajah v. France 453
viktima e drejtpërdrejtë 453
Viktor Orban 125, 126, 431, 690
Vilnius 217, 289, 459, 909, 949
vis-à-vis 420
Vjenë 348, 819, 820
Vladimír Mečiar 620
Vladimir Putin 832
Vojvodina 49, 107, 118, 125, 159, 312, 315, 322, 325
volonte generale 790
VOTA xix, 294
Vrhovna Rada 562
Vushtrria 511, 936

W

Wedel-Jarlsberg 97
Wertordnung 369
Westminster 187, 683, 696
writ of certiorari 651

X / Xh

Xh. Adamas 54
Xhamaika 185, 187
Xhejms Madison 53
Xheremy Bentam 581
Xhezair Zaganjori 438, 827, 902
Xhibuti 78, 277
Xhon Adams 53
Xhonturqit 200
Xhonturqit 224
Xhorxh Jellinek 66

Y

Yango v Japan 270

Z / Zh

Zëri 384, 385, 386, 465, 955, 959
ZËRI DITOR 821, 956
zgjidhja institucionale 172, 193, 238, 243
Zhan Zhak Ruso 363
Zoti 351, 366
Zyra e Prokurorit të Specializuar 374, 409, 412, 413, 826, 935



Prof. dr. Enver Hasani ka qenë kryetari i parë i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (25 qershor 2009–25 qershor 2015). Më parë, ka shërbyer si rektor i Universitetit të Prishtinës dhe dekan i Fakultetit Juridik të këtij universiteti (2006-2009).

Prof. Hasani ka mbajtur edhe poste të tjera të larta civile në Kosovë. Më 2004, kur u themelua Zyra për Marrëdhënie me Jashtë në Qeverinë e Kosovës, u bë shef i parë i saj, duke shërbyer deri më 2006. Në vitin 2000, mori nismën për të themeluar Departamentin e Shkencave Politike dhe Administratës Publike në Universitetin e Prishtinës, dhe u angazhua si udhëheqës fillestar i tij deri më 2002. Në të njëjtën kohë, gjatë viteve 2000–2002, punoi si drejtor themelues i Qendrës për të Drejtat e Njeriut të Universitetit të Prishtinës, që e mundësuan donatorët "Finnish Human Rights Project" dhe "WUS Austria".

Në vitet 1992–1997, prof. Enver Hasani ka punuar si këshilltar ligjor i Ministrisë së Jashtme të Republikës së Shqipërisë. Në cilësinë e këshilltarit juridik, ka marrë pjesë në Konferencën e Rambujesë për Kosovën në kuadër të delegacionit kosovar (shkurt–mars 1999).

Fakultetin Juridik, me çmimin "Student i Dalluar" , prof. Hasani e kryer në Prishtinë (1980-1984), duke diplomuar për tri vite e gjysmë me notë mesatare 9.13. Studimet pos diplomike në drejtimin juridiko-civil i ka kryer në Prishtinë, ku mbrojtur temën e magjistraturës me titull *Ne bis in idem në procedurën kontestimore*. Studimet e dyta të pos diplomës i ka kryer në Universitetin Bilkent të Ankarasë, njëri ndër universitetet më prestigjioze ndërkombëtare, në drejtimin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Në po këtë Universitet, prof. Hasani ka ndjekur studimet e rregullta të doktoratës, të cilat zgjasin pesë vite, por që i ka mbaruar për tri. Temën e disertacionit më pastaj e ka botuar në Vjenë, në ndërkohë që provimet e doktoratës, në katër semestra, i ka ndjekur në sferën multi-disiplinore (shkenca politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare, histori i diplomacisë dhe e drejtë ndërkombëtare publike). Në gjitha provimet e doktoratës (tetë sosh) ka marr notat "A", që është ekuivalent me notën dhjetë në sistemin kosovar. Në mesin e profesorëve të Prof. Hasanit, përfshirë mbikëqyrësit e disertacionit të tij, bjënë pjesë profesorë eminent ndërkombëtar, si i Ali Karaosmaoglu, Norman Stone, Scott Pegg etj.

Gjatë karrierës profesionale, prof. Hasani ka publikuar dhjetëra punime akademike në revista vendore, rajonale e botërore, duke trajtuar aspekte të ndryshme nga e drejta civile, e drejta kushtetuese, e drejta dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.

Ka botuar shtatë libra në fushën e së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, si dhe të drejtës kushtetuese, dy prej të cilëve në anglisht, përfshirë disertacionin e doktoratës që është botuar në Vjenë. Ky është libri i tij i tetë.

Po ashtu është autor i punimeve të ndryshme nëpër përmbledhje të librave të botuara në shtëpitë botuese me famë botërore.

Punimet akademike të Prof. Hasanit gjenden në revistat me famë botërore, si :

- *The Fletcher Forum of World Affairs*
- *Mediterranean Journal of Human Rights*
- *Perceptions*
- *Review of Central and East European Law*
- *Tomas Jefferson Law Review*
- *Vienna Journal on International Constitutional Law*
- *Südosteuropa etj.*

Librat e botuara dhe librat ku prof. Hasani ka qenë ko-editor janë për si vijon:

- *The Dissolution of Yugoslavia and the Case of Kosovo: Legal and Political Aspects*, botuar nga Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare - AIIS, 1999, Tiranë, Shqipëri
- *Self-Determination, Territorial Integrity and International Stability: the Case of Yugoslavia*, botuar nga National Defense Academy and Bureau for Security Policy, 2003, Vjenë, Austri
- *Ne Bis In Idem në Procedurën Kontestimore* (Design House: Prishtinë, 2010)
- *Constitutional Justice in Southeast Europe* botuar nga NOMOS, janar 2012, Baden-Baden, Gjermani (bashkë-editor me ish-kryetarin e Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë Peter Paczolay dhe prof. Michael Reigner)
- *Komentar i Kushtetutës së Republikës të Kosovës*, Botimi I, botuar nga Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar GIZ, dhjetor 2013, Prishtinë, Kosovë (bashkautor me prof. Ivan Cukalovic)
- *Tema të zgjedhura nga e drejta kushtetuese* (Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe JALIFAT Publishing, Prishtinë dhe Huston, SHBA, 2016)
- *Tema të zgjedhura nga e drejta dhe marrëdhëniet ndërkombëtare* (Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe JALIFAT Publishing, Prishtinë dhe Huston, SHBA,, 2016).
- *E drejta kushtetuese: Studim kritik mbi librin "E drejta kushtetuese" të autorëve A. Bajrami e F. Muçaj* (JALIFAT Publishing, Huston, SHBA, dhe Prishtinë, 2019)

Ka mbi një vit që është duke punuar në mënyrë intensive në një tekst tjetër universitare, në librin *E Drejta kushtetuese*, me bashkautorë prof. Përparim Gruda e prof. Zahir Çerkini.

Në libra të edituar, vetëm gjatë viteve të fundit, prof. Hasani ka botuar këto punime:

- Enver Hasani, "Self-Imposed Limitations on Constitutional Jurisdiction: The Case of Kosovo". Në Manuel da Costa Andrade (ed.), *Estudos em Homenagem ao Senhor Conselheiro Presidente Joaquim de Sousa Ribeiro* (EDIÇÕES ALMEDINA, S.A.: Lisboa , Portugal, 2019)
- Enver Hasani, "The Case of the Serb Association before the Constitutional Court of Kosovo", botuar në Andrzej Szmyt and Boguslaë Banaszak (eds), *The Transformation of Laë Systems in Central, Eastern and Southeastern Europe . Liber Amicorum in Honorem Prof. Dr. Dres. H.C. Rainer Arnold* (Gdansk University Press: Gdansk, 2016)
- Enver Hasani, "Basic Features of the Constitutional System in Kosovo". In Rainer Arnold, Jose Ignacio Martinez-Estay (eds.), *Rule of Law, Human Rights and Judicial Control of Power. Some Reflections from National and International Law* (SPRINGER International Publishing AG : Switzerland, 2017)

Prof. Enver Hasani është fitues i disa çmimeve dhe titujve, ndër të cilat veçojmë:

- Doctor Honoris Causa, nga Universiteti Kocaeli, më 19 mars 2013, në Izmit, Turqi
- Çmimi "Leksionet e M.M. McLean për të Drejtën Ndërkombëtare" organizuar nga Universiteti i Pitsburgut, më 24 tetor 2012, në Pitsburg, Shtetet e Bashkuara të Amerikës
- Fitues i bursës *FULBRIGHT* për semestrin dimëror 2005/2006 (Qendra për Studime Ndërkombëtare dhe Krahasuese e Universitetit Northwestern në Chicago, Shtetet e Bashkuara të Amerikës)
- Shfrytëzues i *International Visitor Leadership Program* (IVLP) për vitin 2002, një program shkëmbimi profesional elitar në sferën e edukimit dhe çështjeve të kulturës në mbarë botën, në kuadër të Departamentit Amerikan të Shtetit (Washington, D.C.)

Sot është profesor i së drejtës dhe i marrëdhënieve ndërkombëtare në Universitetin e Prishtinës, kurse kohë pas kohe ka ligjëruar dhe ligjëron nëpër universitete të ndryshme në Evropë, Turqi dhe ShBA. Flet dhe shkruan rrjedhshëm gjuhët angleze e serbe, ka komandë solide të italishtes dhe frëngjishtes, ndërsa në mënyrë pasive komunikon edhe në gjuhën turke.

Është i martuar me Burbuqen. Kanë tre fëmijë: Kastriotin, Vatanin dhe Dënesën, si dhe tre nipa: Ilirikun, Rubinin dhe Priamin.



Muhamet Brahimi

Përvoja e punës:

2017 - **Koordinator i Projektit, Projekti i Reformës Ligjore dhe Administrative të GIZ-it**

- Koordinim i përgjithshëm i Projektit, përfshirë bashkëpunimin me partnerë të tillë si departamenti administrativ i gjykatës themelore dhe organet administrative, koordinimi i donatorëve, monitorimi / raportimi i buxhetit.
- Ofrimi i këshillave për çështje të ndryshme juridike dhe mbajtja e trajnimeve për të drejtën kushtetuese.
- Përfaqësimi i Projektit drejt Ambasadës gjermane në Kosovë, BMZ dhe GIZ si dhe shoqërise civile.

2015 - 2017 **Ekspert i Sundimit të Ligjit të Jashtëm**

- Sigurimi i ekspertizës për Sundimin e Ligjit për organizata të ndryshme, përfshirë Zyrën e Këshillit të Evropës, GIZ dhe Ministrinë e Drejtësisë.
- Fokusi i Projekteve ka qenë edukimi i Sistemit të Drejtësisë së Kosovës në çështjet e të Drejtave të Njeriut, zhvillimin e kapaciteteve midis gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve dhe hartimin e legjislacionit kombëtar në përputhje me standardet e UE-së.

2010 - 2015 **Këshilltar Kryesor Ligjor i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës**

- Sigurimi i performancës dhe funksioneve të Gjykatës Kushtetuese si një shkallë e fundit që siguron respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
- Promovimi i qasjes në drejtësi dhe edukimi i qytetarëve dhe institucioneve.
- Garantimi i integritetit të sistemit të drejtësisë.

2009 - 2010 **Konsulent**

Sigurimi i ekspertizës në çështjet tregtare për Agjencinë e Privatizimit të Kosovës dhe një firmë ligjore lokale.

Shkollimi:

2016 - Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti Juridik Kandidat për PhD (E Drejta Ndërkombëtare Publike) “Identiteti Ndërkombëtar i Unionit Evropian”

2003-2008 Universiteti i Lundit, Fakulteti Juridik LL.M. me një fokus të veçantë në Drejtat e Njeriut, Administrimin e Drejtësisë dhe vendimmarrjen gjyqësore, Drejta tregtare.

2006 - 2007 Universiteti i Lundit, Fakulteti i Gjuhës dhe Letërsisë.

Gjuha Angleze

Gjuhët:

Shqip (Gjuha amtare), Anglisht (rrjedhshëm), Suedisht (rrjedhshëm), Gjermanisht (themelor)

Publikime:

- Identiteti ndërkombëtar i Unionit Evropian dhe roli i tij në rastin e Kosovës, në revistën

"Adjuris" 25 Shtator 2020, Vëllimi 9, numër 2. Nw internet: http://www.adjuris.ro/ revista/index.html (shikuar nw maj 2021)

- Der Immobilienerwerb durch Ausländer im Kosovo/ nga Iset Morina dhe Muhamet

  Brahimi në: Zeitschrift für Europarecht Internationales Privatrecht und Rechtsvergleichung

  (2010), Vol. 51, Issue 5.

- "Komentar - Ligji për proceduren kontestimore".
- Attracting Foreign Investment - The Case of Republic of Kosovo/ by Bedri Bahtiri and

  Muhamet Brahimimi in: Eigth Scientific International Conference - Current Analysis and Expectations of Foreign Investment in the Region of South East Europe, Pristina, November 2015.

- Tying and Bundling/ by Bedri Bahtiri and Muhamet Brahimi in: International Journal of Management and Business Economics, December 2015, Vol. 5, Issue 5.

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

342(075.8)

Hasani, Enver
Gjyqësia kushtetuese / Enver Hasani, Muhamet Brahimi. - Prishtinë : Universieti i Prishtinës "Hasan Prishtina": Fakuteti Juridik, 2021. – 996 f. ; 24 cm.

1.Brahimi, Muhamet

ISBN 978-9951-00-284-4

Çmimi 10 €

ISBN 978-9951-00-284-4

Të gjitha mjetet financiare nga shitja e këtij libri do të shkojnë në fondin e Shoqatës "Down Syndrome Kosova".